REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

2021

Botues:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Bordi redaktues:

Znj. Gresa Caka-Nimani, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Bajram Ljatifi, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Safet Hoxha, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Remzije Istrefi-Peci, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Radomir Laban, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Nexhmi Rexhepi, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Milot Vokshi, Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Njësia Ligjore, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës;

Kontribuesit:

Veton Dula
Saranda Çunaku
Burim Hoxha
Kreshnik Jonuzi
Altin Nika

© 2022 Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjykimeve nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqëson formulimin e vërtetë të vendimeve/aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

2021

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Tabela e Përmbajtjes:

1. Parathënie: 11
2. KI207/19, parashtrues NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve [A.A.U.ZH.nr.20/2019, të 30 tetorit 2019; dhe A.A.U.ZH.nr.21/2019, të 5 nëntorit 2019] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës 13
3. KO95/20, Parashtrues, Liburn Aliu dhe 16 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, të 3 qershorit 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës 87
4. KI230/19, Parashtruesi i kërkesës: Albert Rakipi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019 175
5. MENDIM I PËRBASHKËT KONKURRUES i gjyqtarëve, Bajram Ljatifi, Safet Hoxha dhe Radomir Laban në rastin nr. KI230/19...232
6. KI160/19, KI161/19,KI162/19, KI164/19, KI165/19,KI166/19, KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19, KI171/19, KI172/19, KI173/19 dhe KI178/19, Parashtrues të kërkesës: Muhamet Këndusi dhe të tjerët Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019.....252
7. KI181/19, KI182/19 dhe KI183/19, Parashtrues të kërkesës: Fllanza Naka, Fatmire Lima dhe Leman Masar Zhubi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019 294
8. KI24/20, Parashtrues: "PAMEX SH.P.K", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.179/2017, të 11 nëntorit 2019 329
9. KI86/18, Parashtruese: Slavica Đordević, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CA.nr.2093/2017, të 29 janarit 2018 355

10. KI104/20, Parashtrues, Ejup Koci, Vlerësim i kushtetutshmërisë së procedurave në Gjykatën Themelore në Mitorivcë – Dega në Skenderaj, përkitazi me lëndën C.nr. 256/2018. 400
11. KI45/20 dhe KI46/20, Parashtrues: Tinka Kurti dhe Drita Millaku, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, AA.nr. 4/2020, i 19 shkurtit 2020 dhe AA.nr.3/2020, i 19 shkurtit 2020 412
12. KI220/19, KI221/19, KI223/19 dhe KI234/19, Parashtrues: Sadete Koca Lila dhe të Tjerët; Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019 469
13. KI87/20, Parashtruesi i kërkesës: Suva Rechtsabteilung, Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktvendimit [E.Rev.nr.68/2019] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 27 janarit 2020 507
14. KI177/19, Parashtrues: NNT "Sokoli", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës , Ac.nr.2386/2018, të 17 majit 2019 539
15. KI195/20, Parashtruesi i kërkesës: Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar "Monego", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP.nr. 42/2020, të 25 qershorit 2020 570
16. KI20/21 Parashtrues: Violeta Todorović, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. AC-I-16-0122, të 1 tetorit 2020 621
17. KI240/19, Parashtrues i kërkesës: Enver Latifi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AC.nr. 436/18 të 12 dhjetorit 2018.....641
18. KI113/20, Parashtrues: IF Skadeforsikring, nga Norvegjia, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 62/2020, të 6 prillit 2020 653
19. KI186/19, KI187/19, KI200/19 dhe KI208/19, Parashtrues: Belkize Vula Shala dhe të tjerët, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të

Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019 682
20. KI11/21 Parashtrues, Sami Nuhaj, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 325/2020 të 16 dhjetorit 2020 712
21. KI195/19, Parashtrues: Banka për Biznes, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ae.nr.287/18, të 27 majit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr. 330/2019, të 1 gushtit 2019 747
22. KI51/19, Parashtrues i kërkesës: Qamil Lupçi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ. UZVP. nr. 37/2018 të 5 dhjetorit 2018 794
23. KI188/20, Parashtrues i kërkesës: Kompania e Sigurimeve "SUVA Rechstabteillung", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.63/2019, të 15 tetorit 2020. 824
24. KI111/19, Parashtrues i kërkesës: Kompania e Sigurimeve "SUVA Rechstabteillung", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme E. Rev. nr. 1/2019, të 27 shkurtit 2019.....853
25. KI235/19, Parashtrues i kërkesës: Kompania e Sigurimeve "Allianz Suisse Versicherungs- Gesellschaft AG" Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 32/2019], të 31 korrikut 2019.....885
26. KI74/19, Parashtrues „Suva Rechtsabteilung", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 39/2018, të 8 janarit 2019.....921
27. KO88/21, Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës, Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.....953
28. KI187/20, Parashtrues: Lorik Salihu, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN. nr. 558/2020, të 18 gushtit 2020 980
29. KI59/21, Parashtrues: Partia Demokratike e Kosovës, dega në Gjakovë, kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 416/2020, të 5 nëntorit 2020 998
30. KI175/19; Parashtrues Ismajl Zogaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit [KMLC. nr. 129/2019] të Prokurorit të Shteti, të 13 gushtit

2019, Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, [Ac. nr. 3983/2018], të 24 majit 2019, dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-dega në Malishevë [C.nr. 118/2018] të 2 shkurtit 2018. 1013

31. KI167/20 dhe KI170/20, Parashtrues: *Tasim Zhuniqi dhe Nasip Zhuniqi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 344/2019, të 2 qershorit 2020 1041

32. KI01/20, Parashtrues: Momir Marinković, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-I-17-0074-A123 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 8 tetorit 2019 . 1093

33. KI64/21, Parashtruese: Ali Gjonbalaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 1848/17, të 11 gushtit 2020 1134

34. AKTVENDIM PËR MOSPËRMBARIM lidhur me AKTGJYKIMIN E Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 22 shtatorit 2010 në rastin nr. KI56/09 Parashtruesit Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit..... 1148

35. AKTVENDIM PËR MOSPËRMBARIM lidhur me AKTGJYKIMIN e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 19 majit 2016 në rastin nr. KI132/15 Parashtrues Manastiri i Deçanit..... 1161

36. KI82/21, Parashtrues: Komuna e Gjakovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, UPP-APP. nr. 1/2020, të 28 tetorit 2020 1177

37. KO61/21, parashtrues, Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 08/V-005, të 22 marsit 2021, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës1208

38. KI94/21, Parashtrues: Fatmir Hoti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 5974/2020, të 11 dhjetorit 2020 1246

39. KI100/21, Parashtrues: Moni Commerce Sh.p.k, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP-nr. 72/2020 i 28 tetorit 2020 1269

40. KI01/21, Parashtruese: Ajshe Aliu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 37/2020 të 11 qershorit 2020 1305
41. KI117/21, Parashtrues: Shefqet Nikqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 360/2020, të 2 prillit 2021 1363
42. KI189/20, Parashtrues: IPKO Telecommunications L.L.C, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, ARJ-UZPV.nr.17/2020, të 20 janarit 2020, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës 1385
43. KI63/21, Parashtruesi i kërkesës: Hysen Metahysa, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Istog, GJ.A. nr. 29/21, të 3 shkurtit 2021, në lidhje me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml. nr. 112/2015 të 22 qershorit 2015 1410
44. KI110/20, Parashtrues i kërkesës: Et-hem Bokshi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Plm. nr. 76/2020, të 8 prillit 2020 1436
45. KI114/20, Parashtruesi i kërkesës: Aziz Sefedini, Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të: a) Aktgjykimit C1. nr. 190/07 të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 19 tetorit 2010, dhe, b) Aktgjykimit C1. nr. 686/2009 të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 17 nëntorit 2011 1461
46. KI173/20, Parashtrues: Yusuf Timurhan, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev.nr.392/19, të 2 qershorit 2020.....1494
47. KI123/21, Parashtrues: Luan Telak, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 69/2021, të 18 marsit 2021.....1519
48. KI54/21, Parashtrues: Kamber Hoxha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 393/2020, të 1 shkurtit 2021.....1539
49. KI143/21, Parashtrues: Avdyl Bajgora, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. 558/2020, të 22 shkurtit 2020 1569
50. KI84/21, Parashtrues: Telekomi i Kosovës Sh.A., Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.12/20, të 20 janarit 2021.....1595

51. KO127/21, parashtrues, *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-029, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës 1643
52. KI120/19, Parashtrues: Mursel Gashi, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-17-0568, të 14 marsit 2019..... 1685
53. INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE..... 1731
54. INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS.....1748

Parathënie:

Gjykata Kushtetuese edhe vitin e kaluar vazhdoi punën me efikasitet në trajtimin e ankesave kushtetuese, me përkushtimin e plotë për të siguruar vendimmarrje cilësore, përkundër vështirësive të përballura si rezultat i masave dhe kufizimeve të imponuara nga situata pandemike.
Një punë e tillë efikase u mundësua para së gjithash duke investuar më shumë kapacitete në përdorimin e zgjidhjeve inovative teknologjike për procedimin dhe shqyrtimin e lëndëve, duke ndërmarrë njëherësh të gjitha masat adekuate për ruajtjen e shëndetit të zyrtarëve të Gjykatës dhe të palëve parashtruese.
Dëshmi shtesë dhe reflektim i procesit të rregullt të punës të zhvilluar në Gjykatë janë edhe të dhënat statistikore për vitin e kaluar. Në krahasim me 195 kërkesa të parashtruara dhe 206 lëndë të shqyrtuara gjatë vitit 2020, vitin që shkoi në Gjykatë u parashtruan 235 kërkesa, ndërsa u shqyrtuan 276 lëndë.
Nga këto lëndë të shqyrtuara, ky buletin përmban vetëm aktgjykimet dhe aktvendimet me më rëndësi, në të cilat janë trajtuar një sërë temash komplekse kushtetuese.
Me këtë rast do të veçoja katër kërkesa të parashtruara nga deputetët e Kuvendit, lidhur me: (i) Vendimin e Kuvendit për Zgjedhjen e Qeverisë, të 3 qershorit 2020; (ii) Vendimin e Kuvendit për Zgjedhjen e Qeverisë, të 22 marsit 2021; (iii) Vendimin e Kuvendit për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; si dhe (iv) Rekomandimin e Kuvendit për mbulimin e energjisë elektrike të konsumatorëve në katër (4) komuna të Republikës së Kosovës.
Për më tepër, gjatë vitit të kaluar, Gjykata trajtoi edhe një numër të konsiderueshëm të rasteve sa i përket kërkesave individuale. Në këto të fundit, duke trajtuar pretendimet e parashtruesve të kërkesave dhe duke aplikuar parimet e vendosura nga praktika e saj e konsoliduar gjyqësore dhe ajo e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata ka gjetur shkelje të neneve të Kushtetutës përkitazi me: (i) mungesën e arsyetimit të vendimit gjyqësor; (ii) parimin e barazisë se armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural; (iii) të drejtën për qasje në gjykatë; (iv) mungesën e mbajtjes së seancës dëgjimore; (v) parimin e sigurisë juridike, si pasojë e divergjencës në praktikën gjyqësore; (vi) parimin e paanësisë së gjykatës; (vii) mospërmbarimin dhe respektimin e vendimeve "res judicata"; (viii) pjesëmarrjen e dëshmitarëve dhe trajtimin e provave në procedurë; (ix) tejzgjatjen e procedurave gjyqësore; (x) të drejtën për jetë private; (xi) parimin e barazisë gjinore në përfaqësimin në Kuvend; si dhe (xii) të drejtën për votim të shtetasve të Kosovës nëpërmjet postës.
Për informata më të detajuara përkitazi me rastet e shkeljeve kushtetuese, lexuesit e interesuar mund t'i referohen përmbajtjes së buletinit, i cili përveç se pasqyron praktikën e konsoliduar gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese,

shërben edhe si udhërrëfyes me rëndësi për të gjithë qytetarët, e veçanërisht për pjesëtarët e komunitetit juridik, që të ndërtojnë sa më mirë argumentet e tyre kushtetuese para Gjykatës, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.
Të gjitha aktgjykimet e publikuara në buletin mund t'i gjeni edhe në ueb-faqen e Gjykatës, ku ato publikohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, si dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
Nëpërmjet njoftimeve të rregullta për media, Gjykata, nga viti i kaluar, ka filluar edhe me praktikën e informimit të publikut për çdo aktgjykim të publikuar, përderisa lexuesit e interesuar mund të gjejnë në ueb-faqen e saj edhe statistika periodike përkitazi me numrin e vendimeve të nxjerra, si dhe të dhënat e tjera rreth numrit të lëndëve dhe palëve parashtruese.
Në fund dua të theksoj se, ky buletin dëshmon përkushtimin e Gjykatës për t'u përballur me çdo sfidë dhe çështje kushtetuese, dhe angazhimin serioz për ruajtjen dhe rritjen e besimit të publikut në punën e saj.

Shfrytëzoj rastin që, për këtë, të falënderojë të gjithë gjyqtarët dhe zyrtarët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët me punën e tyre profesionale dhe me kontributin e çmuar e kanë bërë të mundur daljen në dritë të këtij buletini, duke kontribuar kështu në konsolidimin e qëndrueshëm të gjyqësisë kushtetuese të vendit tonë dhe rrjedhimisht në forcimin e sundimin e ligjit të bazuar në standardet evropiane.

Gresa Caka – Nimani

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese

KI207/19, parashtrues NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve [A.A.U.ZH.nr.20/2019, të 30 tetorit 2019; dhe A.A.U.ZH.nr.21/2019, të 5 nëntorit 2019] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

KI207/19, Aktgjykim i miratuar më 10 dhjetor 2020

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, kontrolli i kushtetutshmërisë, të drejtat zgjedhore, votat nga jashtë shtetit, kufizimi i të drejtave zgjedhore*

Kërkesa bazohej në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve [A.A.U.ZH.nr.20/2019, të 30 tetorit 2019; dhe A.A.U.ZH.nr.21/2019, të 5 nëntorit 2019] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, me të cilat, sipas pretendimit, parashtruesit të kërkesës i ishin shkelur të drejtat e garantuara me nenin 7 [Sundimi i Ligjit]; paragrafin 1 të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; dhe nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenin 6 (E drejta për gjykim të drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi vendosjen e masës së përkohshme përmes së cilës do të ndalohej certifikimi *"[...] i zgjedhjeve* [të 6 tetorit 2019] *deri në një vendim përfundimtar [...] lidhur me kërkesën kryesore"* të rastit në fjalë.

Në titullin – **PËRFUNDIME** – të këtij Aktgjykimi, Gjykata përmblodhi esencën e rastit dhe theksoi me sa vijon:

Kërkesa KI207/19 ishte parashtruar nga Koalicioni "NISMA-AKR-PD pas zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të 6 tetorit 2019. Në mënyrë të veçantë, ky rast kishte të bëjë me "Votimin nga Jashtë" të realizuar nga shtetasit e Republikës së Kosovës përmes postës nga vende të ndryshme jashtë Kosovës.

Çështja kushtetuese që ngërthen kërkesa në fjalë është përputhshmëria me Kushtetutën dhe KEDNJ-në e dy vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme, respektivisht Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.20/2019] të 30 tetorit 2019 dhe Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.21/2019] të 5 nëntorit 2019. Konkretisht, nëse vendimmarrja e Gjykatës Supreme se votat nga jashtë

vendit duhet të numëroheshin përkundër faktit që ato kishin arritur në KQZ pas afatit prej njëzet e katër (24) orë nga dita e zgjedhjeve të përcaktuar me nenin 96.2 të LZP-së në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013, ishte në kundërshtim: (i) me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (ii) paragrafin 1 të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenin 6 (E drejta për gjykim të drejtë) të KEDNJ; dhe, (iii) nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira), të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

Sipas fakteve të rastit, PZAP përmes Vendimeve [A.nr.375-2/2019 i 28 tetorit 2019; dhe A.nr.381/2019 i 3 nëntorit 2019] kishte konstatuar se KQZ, sipas LZP-së, nuk duhet t'i numërojë pakot e arritura pas afatit të përcaktuar ligjor e as t'i përfshijë ato në rezultat përfundimtar. Ndërkaq, më pas, Gjykata Supreme kishte rrëzuar vendimmarrjen e PZAP dhe kishte konstatuar se ndonëse qëndron fakti që votat kanë arritur pas afatit ligjor KQZ duhet t'i numërojë ato vota dhe t'i përfshijë në rezultatin përfundimtar. Gjykata Supreme konsideronte se norma ligjore që përcakton afatin, respektivisht neni 96.2 i LZP dhe ai 4.4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 është normë ligjore në "kolizion" me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe se rrjedhimisht duhet urdhëruar KQZ-në që t'i numërojë pakot në fjalë përkundër faktit që ato kanë arritur pas afatit ligjor. Pasi që KQZ zbatoi vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme, rezultati zgjedhor i certifikuar nga KQZ më 27 nëntor 2019, përfshin edhe votat e numëruara nga pakot e kontestuara që kishin arritur pas afatit të përcaktuar ligjor.

Parashtruesit e kërkesës po ashtu pretenduan se Gjykata Supreme në kundërshtim me Kushtetutën ka vendosur të aplikojë drejtpërdrejt instrumentet ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës dhe jo nenin 96.2 të LZP-së dhe nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013. Ata gjithashtu pretenduan se gjykatat e rregullta nuk kanë të drejtë të aplikojnë drejtpërdrejt normat kushtetuese dhe/ose instrumentet ndërkombëtare të parapara në nenin 22 të Kushtetutës, si dhe të interpretojnë normat ligjore në harmoni dhe sipas obligimeve që dalin nga normat kushtetuese, pasi në raste të tilla ekziston një obligim detyrues që sipas nenit 113.8 të Kushtetutës, të referojnë çështjen në Gjykatë Kushtetuese sa herë që ngritët çështja e kushtetutshmërisë së normave ligjore.

Gjykata gjatë trajtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, fillimisht gjeti se sipas interpretimit të nenit 102.3 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 112.1 të Kushtetutës si dhe sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit vlerëson që e drejta dhe obligimi për të aplikuar dhe interpretuar Kushtetutën, ju njihet të gjitha gjykatave të Republikës së Kosovës dhe të gjitha autoriteteve publike në Republikën e Kosovës.

Megjithatë, Gjykata ritheksoi fuqishëm se kompetenca e "konstatimit" të jo-kushtetutshmërisë së një norme ligjore dhe "shfuqizimit" të një norme ligjore si të papajtueshme me Kushtetutën, është kompetencë ekskluzive e Gjykatës Kushtetuese. Pra, përkundër faktit që Kushtetuta ua njeh gjykatave të rregullta kompetencën e interpretimit të një norme të rangut ligjor në harmoni me një normë të rangut kushtetues dhe/ose aplikimin e drejtpërdrejtë të normës së rangut kushtetues, kjo nuk do të thotë se gjykatat e rregullta mund të konstatojnë ose të shpallin një normë ligjore si normë në kundërshtim me Kushtetutën ose KEDNJ-në. Një kompetencë të tillë, të konstatimit të jo-kushtetutshmërisë dhe të shfuqizimit të një norme ligjore, Kushtetuta nuk e ka paraparë si kompetencë për gjykatat e rregullta. Një të drejtë të tillë, Kushtetuta ia ka mveshur në mënyrë ekskluzive vetëm Gjykatës Kushtetuese e cila mund, pas paraqitjes së kërkesës nga një palë e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës, të shfuqizojë një normë ligjore që është në kundërshtim me Kushtetutën si dhe të përcaktojë efektet e një shfuqizimi të tillë.

Sa i përket pajtueshmërisë së vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke marrë për bazë parimet e përgjithshme përkitazi me votimin nga jashtë të vendosura nga GJEDNJ, Gjykata theksoi se megjithëse koha për vendimmarrje në konteste zgjedhore është relativisht e shkurtër dhe se e drejta për një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së nuk aplikohet në kontestet zgjedhore, kjo nuk nënkupton që vendimet që ndërlidhen me konteste zgjedhore nuk duhet të jenë mjaftueshëm të arsyetuara. Sipas GJEDNJ-së, procedura e shqyrtimit të kontesteve zgjedhore duhet të përfshijë patjetër një "vendim mjaftueshëm të arsyetuar" në mënyrë që "të parandalohet abuzimi i pushtetit nga autoriteti relevant vendimmarrës".

Pas aplikimit të këtyre parimeve, Gjykata vlerësoi se arsyetimi i Gjykatës Supreme dhe përfundimet e arritura bazuar në atë arsyetim ishin arbitrare dhe nuk plotësonin asnjë nga kriteret e një vendimi mjaftueshëm të arsyetuar gjyqësor. Kjo për faktin se Gjykata Supreme nuk kishte aplikuar asnjë test relevant të shqyrtimit gjyqësorë e as nuk kishte elaboruar asnjë nga çështjet vijuese që ishin relevante dhe të domosdoshme për tu qartësuar në rrethanat e rastit konkret: (i) çfarë nënkupton "parimi i votimit universal" në të cilin ishte thirrur Gjykata Supreme, si ndërlidhet ai parim me të drejtën e votës nga jashtë dhe si është shkelur i njëjti në rrethanat e rastit konkret; (ii) cilat janë obligimet që neni 3 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së vendosë mbi shtetet përkitazi me votimin nga jashtë; dhe (iii) çfarë është saktësisht ajo që e bën afatin e përcaktuar në nenin 96.2 të LZP në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të jetë normë ligjore në kolizion me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Në këtë aspekt, Gjykata vërejti dhe konstatoi se Gjykata Supreme nuk kishte arritur të vërtetojë, në asnjë mënyrë, se si vendimmarrja e PZAP ishte e gabuar dhe se përse linja e arsyetimit të PZAP duhej zëvendësuar me një linjë krejtësisht tjetër që nuk ishte në përputhje me LZP-në dhe praktikën e deritashme zgjedhore. Rrjedhimisht, Gjykata arriti në përfundimin se Gjykata Supreme nuk kishte ofruar arsyetim të mjaftueshëm ligjor e kushtetues dhe se vendimmarrja e saj në rrethana të rastit konkret ishte arbitrare dhe, për rrjedhojë, në kundërshtim me garancitë e nenit 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Për më tepër, sa i përket përputhshmërisë së normës ligjore që kërkonte që votat për votim nga jashtë duhet të arrijnë në KQZ njëzet e katër (24) orë para ditës së votimit, në mënyrë që të njëjtat të mund të numërohen, Gjykata arriti në përfundim se ky kufizimi i të drejtës së votës: (1) ishte një kufizim i paraparë me ligj; (2) ekzistonte një qëllim legjitim që synohej të arrihej me atë kufizim; si dhe (3) ekziston një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit të së drejtës në fjalë dhe qëllimit legjitim që synohej të arrihej. Gjithashtu, Gjykata gjeti se afati i përcaktuar me nenin 96.2 të LZP-së në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013, nuk ishte arbitrar dhe nuk kishte ndikuar në pamundësim të shprehjes së lirë të vullnetit të popullit përkitazi me përfaqësuesit e vet në Kuvend dhe si i tillë ishte në pajtueshmëri me nenin 45 të Kushtetutës dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Si përfundim, Gjykata njëzëri konstatoi se: (i) kërkesa është e pranueshme për shqyrtim në merita; (ii) vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme nuk janë në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës dhe si të tilla Gjykata i shpallë të pavlefshme; (iii) vendimet e PZAP-së janë në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës; (iv) afati ligjor i përcaktuar nga Kuvendi për arritjen e votave nga jashtë përmes nenit 96.2 të LZP-së në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 ishte një kufizim i të drejtës së votës i cili ishte në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës ngase i njëjti: ishte i paraparë me ligj; kishte një qëllim legjitim që synohej të arrihej me atë kufizim; dhe kishte një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit të kësaj të drejte dhe qëllimit legjitim që synohej të arrihej me atë kufizim; dhe se, në rrethanat e rastit konkret (v) kufizimi i të drejtës së votës (si e drejtë relative dhe jo absolute) me afat nuk ka qenë arbitrar dhe nuk ka ndikuar në pamundësim të shprehjes së lirë të vullnetit të popullit përkitazi me përfaqësuesit e vet në Kuvend.

Për sa i takon efekteve të këtij Aktgjykimi, Gjykata sqaroi se ndonëse konstatimi i saj se vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme nuk janë në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës nuk ka efekt prapaveprues në rezultatin e shpallur zgjedhor në rrethanat e rastit konkret, sipas arsyetimeve të dhëna; megjithatë, Aktgjykimi në këtë rast prodhon të paktën katër efekte të

rëndësishme, si në vijim: (1) sqarimi i të drejtave dhe obligimeve të gjykatave të rregullta për rastet kur ato ballafaqohen me norma të rangut ligjor që pretendojnë se janë në kolizion me norma të rangut kushtetues; (2) shfuqizimi i dy vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme dhe lënia në fuqi e dy vendimeve të PZAP-së ashtu që, përderisa Kuvendi i Republikës së Kosovës e len në fuqi nenin 96.2 të LZP-së, të gjitha votat që arrijnë në KQZ pas afatit të paraparë ligjor duhet të deklarohen si vota të pavlefshme dhe nuk duhet të numërohen e as të përfshihen në rezultat përfundimtar të zgjedhjeve; (3) qartësimi se në rrethanat e rastit konkret nuk ka ekzistuar kolizion në mes të normës së rangut ligjor dhe asaj të rangut kushtetues dhe se, në këtë aspekt, Gjykata Supreme e ka deklaruar kolizionin në fjalë në mënyrë arbitrare, duke tejkaluar kompetencat e saj kushtetuese dhe pa arsyetim të mjaftueshëm dhe adekuat; dhe se (4) gjetja e shkeljes ia mundëson parashtruesit të kërkesës të konsideroj shfrytëzimin e mjeteve tjera juridike në dispozicion për realizimin e mëtejmë të të drejtave të tij në përputhje me gjetjet e këtij Aktgjykimi.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI207/19

Parashtrues

NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimeve [A.A.U.ZH.nr.20/2019, të 30 tetorit 2019; dhe A.A.U.ZH.nr.21/2019, të 5 nëntorit 2019] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Koalicioni parazgjedhor i formuar nga partitë politike NISMA Socialdemokrate ("NISMA"), Aleanca Kosova e Re ("AKR") dhe Partia e Drejtësisë ("PD") (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës ose Koalicioni "NISMA-AKR-PD").

2. Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga z. Albert Maxhuni, nga Vushtrria.

Vendimet e kontestuara

3. Parashtruesi i kërkesës konteston dy Aktgjykime të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), respektivisht Aktgjykimin [A.A.U.ZH.nr.20/2019] të 30 tetorit 2019

dhe Aktgjykimin [A.A.U.ZH.nr.21/2019] të 5 nëntorit 2019 (në tekstin e mëtejmë kur referohen bashkërisht: vendimet e kontestuara).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të lartcekura të Gjykatës Supreme, me të cilat, sipas pretendimit, parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 7 [Vlerat]; paragrafin 1 të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me paragrafin 1 të nenin 6 (E drejta për gjykim të drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

5. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon vendosjen e masës së përkohshme përmes së cilës do të ndalohej certifikimi *"[...] i zgjedhjeve* [të 6 tetorit 2019] *deri në një vendim përfundimtar [...] lidhur me kërkesën kryesore"* të rastit në fjalë.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 19 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 20 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci.

9. Më 21 nëntor 2019, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës, z. Albert Maxhuni, për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë një autorizim të nënshkruar përmes së cilit

vërteton se ai është i autorizuar të dorëzojë kërkesën në Gjykatë dhe se përfaqëson parashtruesin e kërkesës në procedurat para Gjykatës.

10. Në të njejtën ditë, pra më 21 nëntor 2019, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi autorizimin për përfaqësim të Koalicionit "NISMA-AKR-PD" në procedurat para Gjykatës.

11. Më 25 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një plotësim të kërkesës përmes së cilës kërkoi nga Gjykata që, përveç kërkesës fillestare për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.20/2019] të 30 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme, të vlerësohet edhe kushtetutshmëria e Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.21/2019] të 5 nëntorit 2011 të Gjykatës Supreme. Në kërkesën e tij plotësuese, ai theksoi se: *"arsyet për ankesë, baza juridiko-kushtetuese, argumentet kushtetuese dhe kërkesa për shqyrtim [...] mbetën të njejta si në kërkesën tonë të dorëzuar më 19.11.2019"*.

12. Më 25 nëntor 2019, Gjykata i dërgoi nga një kopje të kërkesës dhe nga një kopje të plotësimit të kërkesës institucioneve publike si në vijim: Gjykatës Supreme, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (në tekstin e mëtejmë: PZAP), dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: KQZ).

13. Më 25 nëntor 2019, Gjykata e njoftoi Lëvizjen VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejmë: LVV), në cilësinë e palës së interesuar, për regjistrimin e kërkesës dhe plotësimin e saj si dhe e ftoi atë që të dorëzojë komentet e saj lidhur me kërkesën në tërësi, nëse ka, brenda 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës njoftuese të Gjykatës.

14. Më 2 dhjetor 2019, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata, LVV i dorëzoi komentet e saj në Gjykatë.

15. Më 5 dhjetor 2019, Gjykata i dërgoi parashtruesit të kërkesës një kopje të komenteve të pranura nga LVV si dhe e ftoi atë që të dorëzojë komentet e tij lidhur me komentet në fjalë, nëse ka, brenda 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës së Gjykatës. Brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk pranoi ndonjë koment shtesë nga parashtruesi i kërkesës.

16. Më 5 dhjetor 2019, Gjykata e njoftoi edhe Gjykatën Supreme, PZAP-in dhe KQZ-në për pranimin e komenteve nga pala e interesuar LVV dhe iu dërgoi nga një kopje të komenteve të pranuara, për informatën e tyre.

17. Më 23 dhjetor 2019, Gjykata kërkoi një sqarim nga KQZ përkitazi me autorizimin e dorëzuar në Gjykatë nga parashtruesi i kërkesës. Më specifikisht, Gjykata kërkoi nga KQZ që të sqarojë se: (i) cila subjekte e përbëjnë Koalicionin "NISMA-AKR-PD", të regjistruar me numër 122; (ii) kush është Kryetar, respektivisht person i autorizuar për ta përfaqësuar Koalicionin në fjalë; dhe (iii) kur është certifikuar Koalicioni në fjalë për zgjedhjet e 6 tetorit 2019.

18. Më 24 dhjetor 2019, KQZ dorëzoi sqarimet e kërkuara në Gjykatë së bashku me dokumentacionin përcjellës. Me atë rast, KQZ njoftoi Gjykatën se: (i) Koalicioni "NISMA-AKR-PD" përbëhet nga NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë; (ii) Kryetar i Koalicionit NISMA-AKR-PD është z. Fatmir Limaj ndërsa person kontaktues në emër të Koalicionit NISMA-AKR-PD është z. Albert Maxhuni; dhe se (iii) Koalicioni në fjalë është certifikuar me Vendim të KQZ-së më 9 shtator 2019.

19. Më 18 nëntor 2020, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen për këtë rast të shtyjë për një seancë tjetër.

20. Më 10 dhjetor 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

21. Në të njejtën ditë, Gjykata votoi njëzëri se: (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [A.A.U.ZH.nr.20/2019] i 30 tetorit 2019 dhe Aktgjykimi [A.A.U.ZH.nr.21/2019] i 5 nëntorit 2019 nuk janë në përputhshmëri me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; dhe vendimet e PZAP-së [A.nr.375-2/2019 i 28 tetorit 2019, dhe A.nr.381/2019 i 3 nëntorit 2019] janë në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

22. Më 26 gusht 2019, Presidenti i Republikës së Kosovës nxori Dekretin [nr.236/2019] për caktimin dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi), të cilat u caktuan për datën 6 tetor 2019.

23. Më 9 shtator 2019, Koalicioni "NISMA-AKR-PD" u certifikua si Koalicion i cili do të garonte në zgjedhje si një subjekt me nr. 122.

24. Më 6 tetor 2019, u mbajtën zgjedhjet për Kuvend.

Procedura pas shpalljes së Rezultateve Përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvend

***Faktet e rastit që kanë dërguar deri tek vendimi i parë i kontestuar i Gjykatës Supreme:* Aktgjykimi A.A.U.ZH.nr.20/2019 i 30 tetorit 2019**

25. Më 17 tetor 2019, LVV paraqiti ankesë në PZAP kundër KQZ-së, përmes së cilës kërkoi që të urdhërohet KQZ që t'i bartë në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (në teksin e mëtejmë: QNR) për numërim edhe 4639 pako me fletëvotimeve që kanë arritur me postë por që nuk janë numëruar dhe nuk janë përfshirë në rezultatin përfundimtar zgjedhor.

26. Në ankesë, LVV kishte theksuar se më 16 tetor 2019, rreth orës 23:00 ka përfunduar numërimi i fletëvotimeve me postë dhe janë numëruar gjithsej 13,491 fletëvotime të ardhura me 11,922 dërgesa postare. Sipas tyre, 4639 pako me fletëvotime të ardhura me postë nga qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës nuk janë përfshirë në procesin e numërimit. LVV kishte pretenduar pranë PZAP-së se mosnumërimi i këtyre pakove me vota që kishin arritur me postë paraqet shkelje të nenit 45 të Kushtetutës ngase pengon realizimin e *"vullnetit të qytetarëve që jetojnë jashtë vendit"*.

27. Në të njejtën ditë, më 17 tetor 2019, KQZ parashtroi përgjigje ndaj apelit të LVV. Në përgjigje, KQZ kishte theksuar se në mbledhjen nr. 50/2019 të KQZ-së të datës 12 tetor 2019, ishte diskutuar edhe Raporti lidhur me procesin e votimit jashtë Kosovës. Ky Raport informues sipas KQZ-së, ishte përgatitur nga Departamenti i Operacioneve Zgjedhore – Divizioni i Shërbimit për Votues. Këta të fundit, në Raport kishin theksuar se më 10 tetor 2019, në postën nr. 6, ishin pranuar 4058 dërgesa postare. Të njëjtat, sipas Raportit, ishin konsideruar *"si dërgesa që kanë arritur pas afatit të periudhës së votimit përmes postës."* I njejti Raport kishte konstatuar se dërgesat postare janë nisur për në Kosovë brenda periudhës së votimit, respektivisht me datat 19, 20, 23, 25 deri më 30 shtator 2019 dhe në bazë të nenit 96.2, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (në tekstin e mëtejmë: LZP) dhe pikës 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 për Votim Jashtë Kosovoës (në tekstin e mëtejmë: Rregulla Zgjedhore për Votim Jashtë Kosovës), *"votat jashtë Kosovës duhet të pranohen në KQZ, 24 orë para ditës së*

Zgjedhjeve [njëzet e katër (24) orë para 6 tetorit 2019 – në rrethana të rastit konkret].*"* KQZ, përmes një përgjigjje të dytë sqaruese në apel, konfirmoi se Raporti i lartcekur kishte qenë një raport informues dhe se KQZ në atë mbledhje nuk kishte marrë vendim por kishte kërkuar nga Departamenti i lartcituar që ka përgatitur Raportin që *"ta zbatoj LZP përkatësisht nenin 96.2 të LZP-së dhe Rregullen 03/2013, votimi jashtë Kosove, pika 4.4."*.

28. Më 19 tetor 2019, PZAP shqyrtoi ankesën e lartcekur të LVV, së bashku me përgjigjen në ankesë të dorëzuar nga KQZ, dhe përmes Vendimit [A.nr.375/2019], e hodhi poshtë si të palejuar. PZAP sqaroi se ankesa e LVV duhet të trajtohet si "apel" në kuptim të paragrafit 8 të nenit 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së ngase, sipas PZAP-së, *"në këtë rast, trajtimi i tillë është më adekuat."* PZAP e arsyetoi vendimin e saj për hedhje të apelit si të palejuar duke theksuar se në këtë fazë të procesit zgjedhor pretendimet ankimore të LVV për mos-numërimin e 4639 pakove me fletëvotime *"nuk mund të jetë objekti i vlerësimit"* ngase *"KQZ-ja ende nuk ka marrë vendim lidhur me numërimin e këtyre fletëvotimeve."* Tutje, PZAP kishte qartësuar se nuk është në juridiksionin e PZAP të marrë vendim lidhur me këtë çështje në këtë fazë të procesit duke qenë se KQZ akoma nuk kishte marrë vendim por vetëm kishte raportuar në aspekt të informimit në mbledhjen e saj të 12 tetorit 2019. Në fund, u theksua se PZAP vendos vetëm për vendime të KQZ-së dhe jo për procese të tjera të cilat nuk kanë rezultuar me një vendim konkret.

29. Kundër vendimit të lartcekur të PZAP-së, LVV paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme.

30. Më 25 tetor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.19/2019] e pranoi si të bazuar ankesën e LVV dhe e anuloi Vendimin [A.nr.375/2019] e 19 tetorit 2019 të PZAP-së. Këtë të fundit, Gjykata Supreme e urdhëroi që, në rishqyrtim, të trajtojë sërish ankesën e LVV, të cilën, herën e parë, e kishte hedhur poshtë si të palejuar.

31. Më 28 tetor 2019, PZAP, sipas urdhrit të Gjykatës Supreme, e rishqyrtoi apelin e LVV të paraqitur më 17 tetor 2019. Në rishqyrtim, PZAP përmes Vendimit [A.nr.375-2/2019], e refuzoi, tashmë, si të pabazuar apelin e LVV [*Sqarim:* herën e parë e kishte hedhur poshtë si të palejuar – shih paragrafët më lart].

32. PZAP, në arsyetim të vendimit të tij, theksoi se në mes të palëve në procedurë, respektivisht LVV-së dhe KQZ-së, nuk është kontestuese se

janë pranuar 4639 pako me fletëvotime nga votuesit jashtë shtetit, nga data 8 tetor 2019 deri më 11 tetor 2019, dhe se të njëjtat janë pranuar pas datës së zgjedhjeve me 6 tetor 2019. Po ashtu, sipas PZAP-it, nuk është kontestues as fakti se këto pako me fletëvotime janë dërguar nga votuesit jashtë Kosovës përmes postës në shtetin ku ata jetojnë, nga data 19 tetor 2019 deri më 30 tetor 2019. Kontestuese, sipas PZAP-së, *"mbetet vetëm çështja e vlefshmërisë së këtyre pakove me fletëvotime"* duke qenë se të njëjtat në KQZ *"janë pranuar pas afatit të paraparë ligjor për pranimin e pakove me fletëvotime nga votuese jashtë Kosovë[s]."*

33. Në këtë aspekt, PZAP konstatoi se pretendimet e paraqitura nga LVV *"janë të paqëndrueshme dhe të pabazuar në ligj"* për arsye se KQZ-ja ka vepruar drejtë kur nuk i ka bartur për numërim në QNR 4639 pakot me fletëvotime kontestuese të cilat janë dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar ligjor. Lidhur me afatet ligjore, PZAP iu referua paragrafit 2 të nenit 96 të LZP-së ku përcaktohet se: *"Vota përmes Votimit Jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me anë të rregullave të KQZ-së";* dhe pikës 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 ku përcaktohet që: *"Votat jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja, 24 orë para ditës së zgjedhjeve".*

34. Më tutje, PZAP po ashtu e konsideroi si të pabazuar pretendimin e LVV se me mos dërgimin në numërim në QNR të pakove të pranuara pas afatit ligjor është shkelur neni 45 i Kushtetutës. Në këtë aspekt, PZAP arsyetoi se neni 45 i Kushtetutës nuk është cenuar ngase *"me asnjë veprim apo vendim KQZ-ja, nuk ua ka mohuar të njëjtëve të drejtën për të votuar, pasi që për ta shfrytëzuar të drejtën kushtetuese, për të votuar dhe zgjedhur janë përcaktuar rregullat se si mund të shfrytëzohet kjo e drejtë, siç është përcaktuar me nenin 96 paragrafi 2 i LZP-së, dhe neni 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore Nr. 03/2013, të KQZ-së, çka do të thotë se të njëjtat* [votat nga jashtë] *duhet të arrijnë në KQZ, në afatin prej 24 orëve, para ditës së zgjedhjeve."* PZAP po ashtu theksoi se në këtë rast *"nuk kemi të bëjë me të drejta zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, por kemi të bëjmë me mosrespektim të afateve ligjore, të cilat afat[e] janë prekluzive dhe nuk mund të ndryshohen apo të zgjaten, por vetëm zbatohen siç janë përcaktuar me ligj. Si votuesit brenda Kosovës, që kanë afat ligjorë të votojnë në ditën e votimit kur hapen Qendrat e Votimit [...] siç kanë votuar në këto zgjedhje me datë 06.10.2019, nga ora 07:00 e deri në ora 19:00, që sipas nenit 88 paragrafi 2 të LZP-së, askush nuk mund të hy në Qendrën e Votmit, për të votuar pasi që të mbyllet e njëjta, ashtu edhe për votuesit jashtë Kosovës, është kushti ligjor sipas nenit*

96 paragrafi 2 të LZP-së, që pakot me fletëvotime të pranohen nga KQZ-ja, para ditës së zgjedhjeve, që në këtë rast siç edhe u konstatua më lart 4639 pako me fletëvotime të votuesve jashtë Kosovës, janë pranuar nga KQZ-ja, pas afatit të përcaktuar ligjor".

35. LVV paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të lartcekur të PZAP-it [A.nr.375-2/2019], të 28 tetorit 2019. Në ankesën e tyre, LVV kërkoi që Vendimi i PZAP-së të anulohet si i pabazuar dhe të urdhërohet KQZ që të numërojë të gjitha 4639 pakot me fletëvotime jashtë Kosovës.

36. PZAP paraqiti përgjigje në ankesën e LVV duke theksuar se qëndron prapa konstatimeve të theksuara në Vendimin e kontestuar të PZAP dhe propozoi që ankesa e LVV të refuzohet si e pabazuar.

37. Më 30 tetor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.20/2019] e (i) aprovoi si të bazuar ankesën e LVV; (ii) e ndryshoi Vendimin [A.nr.375-2/2019] e PZAP-it të 28 tetorit 2019; dhe (iii) e detyroi KQZ-në *"që të bëjë rinumërimin e 4639 fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës*".

38. Gjykata Supreme fillimisht paraqiti faktet e rastit dhe më pas theksoi se *"janë të bazuara pretendimet e LVV-së, paraqitur në ankesën ndaj vendimit të kontestuar të PZAP, sepse i njëjti përmban parregullsi dhe për këtë arsye është dashtë të ndryshohet."* Më tutje, arsyetimi relevant i Gjykatës Supreme lexon me sa vijon:

"Me nenin 96 paragrafi 2 (LZP), përcaktohet se vota përmes votimit jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me atë të rregullave të KQZ-së, ndërsa me nenin 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013, përcaktohet se vota jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja, 24 orë para ditës së zgjedhjeve.

Me dispozitën e nenit 31 par. 1 të Kushtetutës [...], garantohet mbrojtja e barbartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organit tjetër shtetëror dhe bartësve të kompetencave publike, ndërsa neni 32 i Kushtetutës garanton se, secili person ka të drejtë të përdor mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj. Me nenin 54 të Kushtetutës, poashtu parashikohet se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte me Kushtetutë ose ligj si dhe të drejtat me mjete efektive ligjore, nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Me nenin 22 të Kushtetutës [...] është përcaktuar zbatimi i drejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare, në rast konflikti, ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike, ndër tjera, edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolet e saj, andaj, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se konkludimi juridik i PZAP-së se apeli i paraqitur nga subjekti politik [...] (LVV) është i pabazuar, bie ndesh me Protokollin 1-Neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo nga fakti se me konkludimin e PZAP-së se dorëzimi i fletëvotimeve për të cilat është ushtruar apeli, që janë pranuar pas ditës së zgjedhjeve, të datës 06.10.2019, janë të pasafatshme, prandaj të njëjtat nuk mund të procedohen si fletëvotime të vlefshme, është në kundërshtim me nenin e cekur i cili garanton të drejtën për të votuar dhe të drejtën për tu zgjedhur. Parimi i votimit universal është shumë i fortë dhe shtetit i kërkohet në mënyrë shumë strikte të justifikojë humbjen e votës nga individë ose kategori të caktuara personash.

Duke u bazuar në gjendje të tillë të çështjes, rezulton konkludimit juridik se neni 96 par. 2 i Ligjit për Zgjedhjet të Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe neni 4 par. 4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 janë në kolizion me nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili përfshin të drejtën për zgjedhje të lira, dhe në rastin konkret votuesit pa fajin e tyre ishin privuar nga mundësia për të shprehur mendimin e tyre në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës, votuesve u është mohuar vetë thelbi i së drejtës për të votuar, siç garantohej nga neni 3 i Protokolli 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në rastin konkret (siç del nga vendimi i kontestuar i PZAP-it) votuesit fletëvotimet i kanë dorëzuar në postë në datat 19, 20, 23, 25 dhe 30 shtator 2019, në kohë të mjaftueshme për të arritur në KQZ, mirëpo, këto fletëvotime kanë arritur në KQZ prej datës 08 deri 11 tetor 2019. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, arritja me vonesë e këtyre fletëvotimeve nuk tangon rregullsinë dhe ligjshmërinë e tyre, meqë, në njërën anë, këta votues kanë votuar në kohën e duhur dhe pa fajin e tyre fletëvotimet e tyre nuk kanë arritur në KQZ para ditës së zgjedhjeve, dhe në anën tjetër, se procesi i numërimit të fletëvotimeve ka qenë në vazhdim e sipër dhe kjo nuk kishte për të ndikuar në rregullsinë e procesit të numërimit të fletëvotimeve. Përkundrazi, mos numërimi i këyre fletëvotimeve, me bazë ligjore dhe kushtetuese, e bën të kontestueshëm gjithë procesin e numërimit të fletëvotimeve në këto zgjedhje parlamentare."

***Faktet e rastit që kanë dërguar deri tek vendimi i dytë i kontestuar i Gjykatës Supreme:* Aktgjykimi A.A.U.ZH.nr.21/2019 i 5 nëntorit 2019**

39. Më 2 nëntor 2019, pas publikimit të Aktgjykimit të parë të kontestuar të Gjykatës Supreme [A.A.U.ZH.nr.20/2019 i 30 tetorit 2019], KQZ veçse ishte urdhëruar nga Gjykata Supreme që të numërojë 4639 pakot me vota të dorëzuara jashtë afatit ligjor të paraparë me LPZ. LVV kishte paraqitur edhe një ankesë tjetër në PZAP – me kërkesë të ngjashme. Në ankesën e dytë, LVV kishte theksuar se më 1 nëntor 2019, rreth orës 17:00, në QNR, gjatë numërimit të 4639 pakove me fletëvotime ishin vënë re se 1806 pako me fletëvotime, pavarësisht se data e dorëzimit të tyre është në përputhje me afatet ligjore të publikuara nga KQZ, nuk ishin dërguar nga Sekretariati i KQZ-së në QNR për verifikim dhe numërim me arsyetimin se këto fletëvotime kanë arritur në KQZ më 17 tetor 2019. Sipas LVV-së, veprimi i Sekretariatit të KQZ ishte në kundërshtim me Aktgjykimin [A.A.U.ZH.nr.20/2019] e 30 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme.

40. KQZ ishte përgjigjur ndaj ankesës së LVV dhe kishte theksuar se *"Sekretariati i KQZ-së ka bërë verifikimin e pakove me fletëvotime për 4639 pako me fletëvotime, të cilat nga vlerësimi i këtyre pakove me fletëvotime, të cilat nga vlerësimi i këtyre pakove ka rezultuar se: 5,882 pako me fletëvotime janë vlerësuar si të individualizuara (pakot e vlerësuara me fletëvotime si të individualizuara, ka rezultuar se brenda një pakoje ka mund të jenë më shumë se një fletëvotim). Nga këto 5,882 pako me fletëvotime të vlerësuara si të individualizuara, 4,670 pako janë aprovuar, të cilat u janë dërguar Qendrës së Numërimit dhe Rezultatve për numërim, ndërsa 1,212 pako me fletëvotime të individualizuara janë refuzuar."* Më tutje, KQZ, njoftoi se, *"më datën 31.10.2019 është prezantuar Raporti njoftues për vlerësimin e pakove me fletëvotime, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [...] A.A.U.ZH.nr.20/2019, i datës 30.10.2019. Në këtë raport, ndër tjerash, në mbledhjen e datës 31.10.2019, i mbajtur në ora 11:30, KQZ-ja është njoftuar se, Sekretariati, me datën 17.10.2019, ka tërhequr nga posta numër 6 në Prishtinë, 1,806 pako të supozuara me fletëvotime, dhe ka rekomanduar KQZ-në, që të marrë vendim për procedim të vlerësimit ose jo, të 1,806 pakot të supozuara me fletëvotime"*.

41. Më 3 nëntor 2019, PZAP nxorri Vendimin [A.nr.381/2019] përmes së cilit refuzoi si të pabazuar ankesën e LVV. Fillimisht, PZAP sqaroi se nuk është kontestuese për palët në procedurë se 1806 pako me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës janë pranuar në KQZ më 17 tetor 2019, respektivisht disa ditë pas zgjedhjeve të 6 tetorit 2019.

Gjithashtu, nuk ishte kontestues faktin se ato fletëvotime ishin dorëzuar nga votuesit jashtë Kosovës përmes postës nga data 19 shtator 2019 deri më 30 shtator 2019. Kontestuese, sipas PZAP-së, *"mbetet vetëm çështja e vlefshmërisë së këtyre pakove me fletëvotime, si të rregullta dhe të vlefshme, pasi që në KQZ, të njëjtat janë pranuar pas afatit të paraparë ligjor, për pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës".*

42. Më pas, PZAP arsyetoi vendimin e saj për të shpallur si të pabazuar ankesën e LVV duke theksuar se pretendimet *"janë të paqëndrueshme dhe të pabazuar në ligj"* ngase KQZ-ja ka vepruar drejtë kur nuk i ka bartur në QNR pakot me 1806 fletëvotime të pranuara më 17 tetor 2019 për arsye se neni 96 paragrafi 2 i LZP parasheh që: "*Vota përmes votimit jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me anë të rregullave të KQZ-së",* ndërsa me nenin 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013, përcaktohet se *"Votat jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja, 24 orë para ditës së zgjedhjeve."* Rezulton që, sipas PZAP-së, të gjitha fletëvotimet janë pranuar pas ditës së zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 dhe rrjedhimisht *"të njëjtat nuk mund të procedohen si fletëvotime të vlefshme".*

43. PZAP theksoi po ashtu se LZP *"është ligj material juridik dhe procedural i cili në mënyrë shprehimore dhe të qartë, ka përcaktuar afatin se kur pakot me fletëvotime duhet të arrijnë në KQZ, për t'u trajtuar si të vlefshme (ky afat është 24 orë, para ditës së zgjedhjeve siç përcaktohet me nenin 96 paragrafi 2 të LZP-së dhe neni 4 i Rregullës Zgjedhore Nr. 03/2013), dhe se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me situata të pa përcaktuara me LZP-në dhe me Rregulla Zgjedhore, që mund të gjenin përshtatshmërish[t] zbatim dispozitat e LPK-së. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës është në përputhje me Konventë[n] Evropiane për Të Drejtat e Njeriut, respektivisht me protokollet shtesë të saj, më konkretisht me nenin 3.3 të këtij protokolli shtesë, sepse ky kontroll parasheh obligime për shtetet që të sigurojnë mekanizma që iu mundësojnë qytetarëve të ushtrojnë të drejtën e tyre, për të zgjedhur apo për tu zgjedhur, ndërsa neni 96 i LZP-së, nuk e cenon një të drejtë të tillë, por e kufizon afatin e pranimit të fletëvotimit, dhe në këtë rast votuesit jashtë Kosove, kanë pasur afat të mjaftueshëm kohor, për të shfrytëzuar të drejtën e tyre të votës. Këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar mijëra votues të tjerë jashtë vendit, në afatet e përcaktuara me ligj dhe pakot me fletëvotime të të njëjtëve, janë trajtuar të vlefshme.*

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës është nxjerrë në përputhje me praktikat më të mira të shteteve anëtare të

BE-së, ku pjesa dërrmuse e këtyre shteteve e kanë përcaktuar se fletëvotimet duhet ta arrijnë para ditës së zgjedhjeve, ndërsa një pakicë e shteteve e kanë të rregulluara në atë mënyrë që fletëvotimet duhet të arrijnë deri në mbylljen e vendvotimeve në ditën e zgjedhjeve. Krejt kjo i kontribuon garantimit të integritetit të procesit zgjedhor, pasi pranimi i pakove me fletëvotime, pas afatit ligjor të cekur më lartë e minon dhe cenon integritetin e procesit zgjedhor. Në këtë frymë janë edhe rekomandimet e (...) Komisionit të Venecias, Kodi i Praktikës së Mirë në çështjet zgjedhore i miratuar datë: 18-19 tetor 2002, të cilat parashohin: "Votimi me postë do të zhvillohej nën një procedurë të veçantë disa ditë para zgjedhjeve.

Pranimi dhe trajtimi i pakove me fletëvotime të arritura pas afatit, përveç cenimit të integritetit të procesit zgjedhor e fut KQZ-në, në një rreth vicioz nga i cili është problem të dilet, sepse kjo ia mundëson KQZ-së, që në një afat optimal, të shpall rezultatin zgjedhor dhe nuk afatizon procesin e pranimit të pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë vendit. Kjo i bie në kundërshtim me qëllimin e ligjvënësit, pasi ligjvënësi ka pasur për qëllim që të caktoj afatin ligjor, brenda të cilit duhet të përmbyllet procesi i pranimit të pakove me fletëvotime, pasi në të kundërtën kjo do të shkonte në pafundësi të përmbylljes së këtij procesi zgjedhor."

44. Përkitazi me pretendimet e LVV për shkelje të nenit 45 të Kushtetutës, PZAP e konsideroi këtë pretendim të pabazuar ngase KQZ me asnjë veprim apo vendim nuk ua ka mohuar votuesve të drejtën për të votuar. Për të shfrytëzuar të drejtën kushtetuese për të votuar dhe zgjedhur janë përcaktuar rregullat se si mund të shfrytëzohet kjo e drejtë, siç përcaktohet me nenin 96.2 të LZP dhe nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 të KQZ-së. Afati me ligj dhe rregulla ka qenë 24 orë para ditës së zgjedhjeve.

45. Kundër Vendimit [A.nr.381/2019] të PZAP, LVV parashtroi ankesë pranë Gjykatës Supreme duke propozuar që ankesa të pranohet dhe Vendimi i PZAP-së të anulohet si i pabazuar dhe të urdhërohet KQZ për numërimin e të gjitha pakove me fletëvotime të votuesve jashtë Kosovës.

46. PZAP paraqiti përgjigje në ankesë duke theksuar se qëndron prapa konstatimeve të paraqitura në Vendimin e kontestuar të PZAP-it. Ky i fundi propozoi që ankesa e LVV të refuzohet si e pabazuar.

47. Më 5 nëntor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.21/2019] e (i) aprovoi si të bazuar ankesën e LVV; (ii) e

ndryshoi Vendimin [A.nr.381/2019] të 3 nëntorit 2019; dhe (iii) e detyroi KQZ-në që të bëjë numërimin e 1806 fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës.

48. Gjykata Supreme fillimisht qartësoi se: *"Nga shkresat e lëndës rezulton se nuk është kontestuese se këto pako të fletëvotimeve Sekretariati i KQZ me datën 17.10.2019 i ka tërhequr nga Posta nr. 6 në Prishtinë, do të thotë shumë ditë pas datës 6 tetor kur janë mbajtur Zgjedhjet Parlamentare në Republikën e Kosovës. Po ashtu nuk është kontestues fakti se këto pako me fletëvotime janë dorëzuar nga votuesit jashtë Kosovës, për mes postës në shtetin ku jetojnë, nga data 19.09.2019 e deri më datën 30.09.2019. Kontestues mbetet fakti se këto pako me fletëvotime a janë të vlefshme apo jo me që në KQZ kanë arritur pas afatit të paraparë ligjor".*

49. Më pas, Gjykata Supreme e arsyetoi vendimin e saj më sa vijon:

"Qëndron fakti se me nenin 96 paragrafi 2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), përcaktohet se vota përmes votimit jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me anë të rregullave të KQZ-së, ndërsa me nenin 4 paragrafi 4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013, përcaktohet se vota jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja, 24 orë para ditës së zgjedhjeve.

Mirëpo, me dispozitën e nenit 31 par. 1 të Kushtetutës [...], garantohet mbrojtja e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organit tjetër shtetëror dhe bartësve të kompetencave publike, ndërsa neni 32 i Kushtetutës garanton se, secilin person ka të drejtë të përdor mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj. Me nenin 54 të Kushtetutës, po ashtu parashikohet se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte me Kushtetutë ose ligj si dhe të drejtat me mjete efektive ligjore, nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Ndërsa me nenin 22 të Kushtetutës [...] është përcaktuar zbatimi i drejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare, në rast konflikti, ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike, ndër tjera, edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj, andaj, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se konkludimi juridik i PZAP-së se apeli i paraqitur nga subjekti politik [...] (LVV) është i pabazuar, bie ndesh me Protokollin 1-Neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo nga fakti se me

konkludimin e PZAP-së se dorëzimi i fletëvotimeve për të cilat është ushtruar apeli, që janë pranuar pas ditës së zgjedhjeve, të datës 06.10.2019, janë të pasafatshme, prandaj të njëjtat nuk mund të procedohen si fletëvotime të vlefshme, është në kundërshtim me nenin e cekur i cili garanton të drejtën për të votuar dhe të drejtën për tu zgjedhur. Parimi i votimit universal është shumë i fortë dhe shtetit i kërkohet në mënyrë shumë strikte të justifikojë humbjen e votës nga individë ose kategori të caktuara personash.

Duke u bazuar në një gjendje të tillë të çështjes, rezulton konkludimi juridik se neni 96 par 2. i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe neni 4 par.4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 janë në kolizion me nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili përfshin të drejtën për zgjedhjet e lira, dhe në rastin konkret votuesit pa fajin e tyre ishin privuar nga mundësia për të shprehur mendimin e tyre në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës, votuesve u është mohuar vetë thelbi i së drejtës për të votuar, siç garantohej nga neni 3 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në rastin konkret (siç del nga vendimi i kontestuar i PZAP-it) votuesit jashtë Kosovës, 1806 pako me fletëvotime i janë dorëzuar për mes postës në datën 19.09.2019 e deri më datën 30.09.2019, në kohë të mjaftuar për të arritur në KQZ, mirëpo, këto fletëvotime Sekretariati i KQZ i ka tërhequr në Postën nr. 6 në Prishtinë më datën 17.10.2019. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, arritja me vonesë e këtyre fletëvotimeve nuk tangon rregullsinë dhe ligjshmërine e tyre, meqë, në njerën anë, këta votues kanë votuar në kohën e duhur dhe pa fajin e tyre fletevotimet e tyre nuk kanë arritur në KQZ para ditës së zgjedhjeve, dhe në anën tjetër, se procesi i numërimit të fletevotimeve ka qenë në vazhdim e sipër dhe kjo nuk kishte për të ndikuar në rregullsinë e procesit të numërimit te fletëvotimeve. Perkundrazi, mos numërimi i këtyre fletëvotimeve, me bazë ligjore dhe kushtetuese, e ben të kontestueshem gjithë procesin e numerimit të fletëvotimeve në këto zgjedhje parlamentare, aq më tepër kur deri në shpalljen e rezultateve perfundimtare ka mundesi që votat e të gjithë votuesve si brenda e po ashtu edhe jashtë Kosovës, të verifikohen dhe të numerohen.

Së këndejmi, u refuzuan u refuzuan si të pa bazuara pretendimet e PZAP sipas te cilave Ligji për Zgjedhje të Pergjithshme është në pajtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këto pretendime janë të pa bazuara, jo vetme për arsyet e sipër përmendura, por edhe nga fakti se shteti ka për obligim të sigurojë

mekanizem të posaçem në menyrë që qytetarët pa ndonjë pengesë objektive të ushtrojnë të drejtën e tyre për të zgjedhur, ndersa në rastin konkret një pengesë e tillë e mos arritjes me kohë të fletevotimeve në destinacionin e përcaktuar, pa fajin e votuesve, e nën përgjegjësinë e Shtetit, e cenon KEDNJ."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

50. Parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Koalicioni "NISMA-AKR-PD", pretendon se me dy vendimet e kontestuara, Gjykata Supreme ka bërë shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 7 [Vlerat] të Kushtetutës, 45 [të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës si dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ. Pra, parashtruesi pretendon se është shkelur neni i Kushtetutës që flet për *"vlerat"*; neni i Kushtetutës që flet për *"të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes"* si dhe neni i Kushtetutës dhe KEDNJ-së që garanton *"të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm"*.

51. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e kontestuara janë *"arbitrar[e] në tërësi për shkak të interpretimit me hamendje të dispozitave kushtetuese të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, të rolit dhe pozitës së normave kushtetuese lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare nga ky nen, si dhe arbitrar lidhur me rolin dhe pozitën kushtetuese të nenit 3 të Protokollit 1 [E drejta për zgjedhje të lira] të [KEDNJ] dhe "Protokolli 1"."*

52. Parashtruesi i kërkesës duke u thirrur në arsyetimin ku Gjykata Supreme i është referuar nenit 22 të Kushtetutës kur ka vendosur ta bazojë vendimin e saj në Kushtetutë e jo në LPZ thekson se nga ky interpretim shihet qartë se Gjykata Supreme *"nuk kupton se dispozitat kushtetuese të nenit 22 [...] kanë fuqi të njëjtë kushtetuese si çdo dispozitë tjetër dhe se funksioni i kësaj dispozite nuk është që të autorizoj shmangien e zbatimit të ligjeve pozitive të Kosovës, por të detyroj Shtetin e Kosovës që të garantoj vënien në jetë të lirive dhe të drejtave të garantuara me ato marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare që përmenden në atë nen"*.

53. Parashtruesi i kërkesës argumenton se *"Kushtetuta fare nuk autorizon asnjë organ tjetër shtetëror, përfshirë Gjykatën Supreme, për të mënjanuar apo shmangur zbatimin e ligjeve kur ato bien në*

kundërshtim me normat kushtetuese. Në një rast të tillë, pra kur gjykatat vijnë deri te një konstatim se ligji apo norma që duhet ta zbatojnë është kundër kushtetuese, atëherë ato kanë autorizimin e vetëm për të iniciuar procedurat e kontrollit incidental, sipas nenit 113.8 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës". Andaj, sipas parashtruesit të kërkesës, "*çdo dyshim për kushtetutshmërinë e [Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme] është dashur të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese për kontroll incidental kushtetues, jo të bëhet shmangia e zbatimit të tij, siç ka vepruar Gjykata Supreme në mënyrë arbitrare".*

54. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme në mënyrë arbitrare i ka cilësuar si norma ligjore normat e dispozitat e nenit 3 të Protokollit nr. 1, sikur ato të ishin norma të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuara në kuptim të nenit 19.2 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të Gjykatës KO95/13, duke theksuar se Gjykata Kushtetuese ka sqaruar se marrëveshjet ndërkombëtare bëhen pjese e sistemit juridik vendor, që dallon nga neni 22 i Kushtetutës sepse ky nen përbën vullnetin e sovranit të Kosovës, duke ua njohur statusin e dispozitave kushtetuese marrëveshjeve të cekura në nenin 22 të Kushtetutës. Parashtruesi argumenton se *"normat e nenit 22 janë norma të Kushtetutës dhe askush nuk mund të vlerësoj nëse një normë ligjore bie ndesh me to, përveç Gjykatës Kushtetuese".*

55. Parashtruesi i kërkesës pretendon se arbitrariteti i dytë konsiston në faktin se *"Gjykata Supreme nuk e ka kuptuar natyrën juridike të normës së nenit 3 të Protokollit 1 të KEDNJ. Ai nen nuk ka fare të bëj me gjykatat e vendeve që janë palë të KEDNJ, por vetëm me shtetet anëtare. Si i tillë, ky nen ngërthen një detyrim për shtetet anëtare apo palë të KEDNJ për të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të realizuar të drejtën e parashkruar në të dhe nuk ka natyrë të vetë zbatueshme, d.m.th. nuk mund të zbatohet drejtpërdrejtë nga gjykatat nacionale sepse nuk ka çfarë të zbatohet."* Lidhur më këtë parashtruesi i kërkesës potencon se *"Kosova këtë detyrim e ka realizuar kur ka futur në Kushtetutën e vet dispozitën e nenit 45 dhe kur ka nxjerr LZP, si dhe kur ka ndërtuar gjithë infrastrukturën tjetër përcjellëse institucionale dhe financiare për vënien në jetë të detyrimit nga neni 3 i Protokollit 1".*

56. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme është vënë *"në rolin e mbikëqyrësit të KEDNJ"* duke theksuar se rolin mbikëqyrës të zbatimit të KEDNJ e ka GJEDNJ dhe asnjëherë gjykata nacionale. Sipas parashtruesit, *"Kushtetuta në nenin 53 [Interpretimi Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] e vënë si*

detyrim për krejt autoritetet publike, jo zbatimin e drejtpërdrejtë të KEDNJ, por detyrimin për të interpretuar dispozitat e saj sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ." Andaj, parashtruesi pretendon se këtë nuk e ka bërë Gjykata Supreme, e cila "*në mënyrë arbitrare ka ushtruar funksionin e mbikëqyrësit të zbatimit të KEDNJ në nivel të Kosovës sa i përket zgjedhjeve për Kuvend."* Parashtrues i kërkesës po ashtu pretendon se Gjykata Supreme ka bërë *"kontrollin e kushtetutshmërisë së LZP duke marrë si parametër matës normën kushtetuese nga neni 22 që ka të bëj me KEDNJ dhe protokollet e saj"*.

57. Parashtruesi i kërkesës pretendon se dispozitat e konventave të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës nuk janë të vet-ekzekutueshme, dhe ato duhet të zbatohen përmes ligjeve, në rastin konkret përmes LZP dhe në këtë rast kushtetutshmëria e LZP-së *"prozumohet sepse është nxjerrë në bazë të Kushtetutës dhe me qëllim të vënies në jetë të lirive dhe të drejtave kushtetuese që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe që ankorohen në nenin 45 të Kushtetutës"*. Sipas parashtruesit të kërkesës, kur gjykatat gjykojnë sipas "kushtetutës dhe ligjit" konform nenit 102, paragrafi 3 të Kushtetutës kjo nuk do të thotë se *"gjykatat interpretojnë kushtetutën e aq me pak se mund ta përdorin atë si bazë të drejtpërdrejt për vendimmarrje"*.

58. Parashtruesi i kërkesës vazhdon më tutje se *"LPZ dhe krejt infrastruktura tjetër e ndërtuar me qëllim të realizimit të të drejtave kushtetuese nga neni 45 i Kushtetutës ekzistojnë edhe janë krijuar për te vënë në jete detyrimin ndërkombëtar të Kosovës nga neni 3 i Protokollit 1 dhe detyrë e Gjykatës Supreme është zbatimi unik i ligjit në rastet konkrete për krejt territorin e Kosovës. Këtë detyre e ka çdo gjykatë supreme në sistemin kontinental dhe njihet si funksioni nomofilaktik i gjykatave supreme. [...] Duke realizuar këtë funksion përmes interpretimit unik të LZP dhe të ligjeve të tjera në krejt territorin e Kosovës, Gjykata Supreme e realizon kushtetutshmërinë dhe sigurinë juridike në nivel vendi."* Parashtruesi potencon se ky funksion primar i Gjykatës Supreme, [...] është konstatuar në një Aktgjykim të vetë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, duke cekur rastin KI25/10 të Gjykatës dhe duke theksuar se me këtë rast Gjykata Kushtetuese e ka bërë të qartë se Gjykata Supreme nuk mund të zgjedh se cilin ligj apo normë të Kosovës do ta zbatojë apo t'i trajtojë organet e themeluara me ligj si organe jo legjitime në pikëpamje kushtetuese.

59. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se Gjykata Supreme "*luan rolin e ligjvënësit, sepse anulon afatet e përcaktuara me nenin 96.2 të LZP dhe me rregullativën e brendshme të KQZ, të cilat afate prezumohet se janë kushtetuese."* Parashtruesi më tej shton se *"duke bërë këtë, Gjykata Supreme i ka imponuar në mënyrë arbitrare*

afatet e veta që janë të zakonshme dhe që gjenden nëpër ligjet e ndryshme të përgjithshme që rregullojnë procedurat gjyqësore në Kosovë (procedurat administrative, civile dhe penale). [...] Këto ligje dhe këto afate nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë relevancë në LZP nisur nga fakti se këtu nuk bëhet fjalë për ruajtjen e afateve për nevoja individuale gjyqësore, por për realizimin e të drejtave kushtetuese zgjedhore që kanë të bëjnë dhe ushtrohen në kontekstin e proceseve politike zgjedhore".

Pretendimet lidhur me kërkesën për masë të përkohshme

60. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme lidhur me rastin. Parashtruesi i kërkesës thekson se kërkesa është *prima facie* e themeltë, ashtu që mos vënia e masës së përkohshme mund të shkaktojë dëm të pariparueshëm dhe është në interes publik.

61. Lidhur me themelësinë *prima facie* të meritave të rastit parashtruesi i rithekson pretendimet e elaboruara me lart lidhur me meritat e rastit. Ai më tej thekson se zbatimi i drejtpërdrejtë i nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ *"ka rrënuar sigurinë juridike të subjekteve që kanë garuar në zgjedhjet e 6 tetorit [...]. Me këtë zbatim parashtruesit të Kërkesës ia ka humbur votat e rregullta te qytetarëve të Kosovës, duke ndikuar në rritjen e pragut zgjedhor dhe humbjen e votave në proporcion me këtë rritje jo kushtetuese të pragut zgjedhor".*

62. Lidhur me dëmin e pariparueshëm dhe interesin publik për vënien e masës së përkohshme, parashtruesi i kërkesës potencon se *"i vetmi institucion që mund të pengojë një arbitraritet të mëtutjeshëm është Gjykata Kushtetuese, e cila ka tagër për vënien e masës së përkohshme ndalim certifikimin e zgjedhjeve deri në një vendim përfundimtar të saj lidhur me kërkesën kryesore të përshkruar si me sipër. [...] sikundër u pa nga arsyetimi si me sipër, parashtruesi mjaftueshëm ka dëshmuar prima facie se rasti ka merita ashtu që vënia e masës së përkohshme është në interes publik dhe pengon krijimin e një dëmi të pariparueshëm për demokracinë parlamentare kosovare, ne veçanti për sundimin e ligjit ne procesin e formimit te organeve qendrore te Shtetit te Kosovës".*

63. Parashtruesi i kërkesës po ashtu thekson se interesi publik do të mbrohej me vënien e masës së përkohshme për shkak se do të kontribuonte në forcimin e demokracisë kushtetuese duke garantuar respektimin e rregullave të lojës politike dhe të normave kushtetuese

që garantojnë konkurrencë të drejtë dhe pluraliste të ideve dhe projekteve të ndryshme politike.

64. Sa i përket dëmit të pariparueshëm, parashtruesi i kërkesësn shtoi se *"Dëmi i pariparueshëm ndërkaq, do të pengohej nga shkaktimi për arsye se do të ruhej dinjiteti i votës së qytetarit dhe i Kuvendit të Kosovës, sepse çdo vendim i Gjykatës Kushtetuese që do të konstatonte jo-kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar do te çonte në njollosjen e procesit zgjedhor dhe në shkaktimin e problemeve shtesë në rindarjen e vendeve të deputetëve që mund të kenë dhënë betimin dhe të jenë ulur në karriget e Kuvendit të Republikës".*

Kërkesa përfundimtare e parashtruesit të kërkesës

65. Ne fund, Koalicioni "NISMA-AKR-PD", në cilësi të parashtruesit, kërkoi nga Gjykata që: (i) të shpallë kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita; (ii) të vendos masë të përkohshme; (iii) të anulojë Aktgjykimet e kontestuara të Gjykatës Supreme; dhe, (iv) të urdhërojë Gjykatën Supreme që *"të eliminoj jo-kushtetutshmërinë e gjetur në pajtim me arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese".*

Komentet e dorëzuara nga LVV

66. Në komentet e saj lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, LVV ngrit ekskluzivisht çështjen e shterjes së mjeteve juridike nga parashtruesi i kërkesës si "kusht paraprak të domosdoshëm" për pranueshmërinë e kërkesës para Gjykatës.

67. Lidhu më këtë, LVV thirret në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) të Rregullores së punës që përcaktojnë që Gjykata mund të shqyrtoj një kërkesë kundër një akti të autoriteti publik nëse janë shteruar mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj.

68. LVV pretendon se *"palët parashtruese kanë dështuar të përmbushin këtë kusht të domosdoshëm paraprak, duke mos i shtere mjetet juridike, që e bën të papranueshëm një kërkesë të tillë. Në lidhje me këtë rregull, në cilësi të kushtit paraprak, në kuptim të shterjes se mjeteve juridike, Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë një mori Aktvendime për Papranueshmëri si pasojë e mosplotësimit të këtij kushti nga palët parashtruese".*

69. LVV i referohet rastit KI152/17 (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese me parashtrues *Shaqir Totaj*, Aktvendimi për papranueshmëri i 17 janarit 2018) në të cilin rast Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se *"parashtruesi i kërkesës nuk ka shteruar asnjë mjet juridik në emrin e tij personal, pra si person fizik apo si "person i cili ka interes ligjor", pranë PZAP-it apo pranë Gjykatës Supreme, para se të dorëzonte kërkesën e tanishme në Gjykatën Kushtetuese."*

70. LVV pretendon se *"palët e autorizuara nuk kanë shteruar mjetet juridike në rastin e kontestimit të Aktgjykimit AA.UZH.nr.20/2019, në Gjykatën Kushtetuese, për faktin se koalicioni parazgjedhor Nisma-AKR-PD nuk kanë bërë ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të PZAP-së, në përputhje me legjislacionin zgjedhor në fuqi, me pretendimin e shkeljeve të caktuara kushtetuese. Koalicioni Nisma-AKR-PD, si palë parashtruese, ka kontestuar Aktgjykimin AA.UZH.nr.20/2019, të Gjykatës Supreme në Gjykatë Kushtetuese, duke ditur se palë në procedurë në Gjykatën Supreme ka qenë [LVV] dhe PZAP. Për me tepër, në kontestimin e vendimit të PZAP-së në Gjykatë Supreme dhe në nxjerrjen e aktgjykimit AA.UZH.nr.20/2019, nga Gjykata Supreme, nuk përmendet asnjëherë pala parashtruese. Kësisoj, pala parashtruese gjatë procesit zgjedhor dhe në përputhje me nenin 119 lidhur me nenin 122 dhe 118 par. 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ka dështuar që të bëjë ankesë në PZAP, pastaj në Gjykatën Supreme, brenda afatit të caktuar, në mënyrë që të fitojë të drejtën në përmbushje të kushtit paraprak, siç është shterimi i mjeteve juridike për shqyrtim të një çështje kushtetuese, nga Gjykata Kushtetuese e Republikës se Kosovës".*

71. LVV po ashtu pretendon se asnjë autoritet publik nuk ia ka cenuar të drejtat kushtetuese parashtruesit të kërkesës duke shtuar se ky i fundit nuk i është drejtuar instancave të gjykatave të rregullta për të parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Lidhur me parimin e subsidiaritetit në këtë kontekst, LVV i referohet rastit të GJEDNJ *Selmouni kundër Francës* (shih kërkesa nr. 25803/94) si dhe rasteve: KI48/18 (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 23 janarit 2019) dhe KI34/17 (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese me parashtrues *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershor 2017).

72. Lidhur me masën e përkohshme, LVV pohon se parashtruesi i kërkesës nuk ka *"mundur në asnjë çast të vetëm të mbështesin kërkesën për masë të përkohshme me prova, apo të paraqesin fakte*

të cilat do të krijonin besim dhe bindje në Gjykatën Kushtetuese, duke ditur që palët parashtruese me mosveprimet e tyre kanë dështuar të përmbushin kriteret e pranueshmërisë së kërkesës kushtetuese, në lidhje me mos shterimin e mjeteve juridike".

73. Në fund, LVV i propozon Gjykatës që kërkesën në fjalë ta deklarojë si të papranueshme dhe të refuzojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për masë të përkohshme.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 3
(E drejta për Zgjedhje të Lira)

Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 45
[Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.
2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Neni 55
[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.

4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar."

Ligji 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme i 5 qershorit 2008, publikuar në Gazetë Zyrtare më 15 qershor 2008 (përfshi plotësim ndryshimet të 29 tetorit 2010, publikuar në Gazetë Zyrtare më 16 nëntor 2010)

KREU XIV
VOTIMI JASHTË KOSOVËS

Neni 96
Dispozitat e Përgjithshme

96.1 Votuesi me të drejtë vote i cili përkohësisht mungon në Kosovë mund të votojë për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës nëse ai ose ajo ka aplikuar suksesshëm për Votim Jashtë Kosovës dhe ka votuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e KQZ-së.
96.2 Vota përmes Votimit Jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me anë të rregullave të KQZ- së.

Rregulla Zgjedhore nr. 03/2013 – Votimi nga Jashtë, në fuqi nga data 2 korrik 2013

Neni 1
Dispozitat e Përgjithshme

Kjo rregull ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e regjistrimit për të votuar nga jashtë Kosovës, pranimin e fletëvotimit, mënyrën e votimit dhe numërimin e fletëvotimeve nga jashtë Kosovës.

Neni 4
Mënyra e votimit

[...]

4.3 Pas plotësimit të fletëvotimit për votim jashtë Kosovës, votuesi duhet ta dërgojë atë me postë në njërën nga kutitë postare që ngrihen dhe shpallen publikisht nga KQZ-ja, deri në datën që përcaktohet nga KQZ-ja.

4.4 Votat jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja 24 orë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 5
Numërimi i fletëvotimeve për Votim Jashtë Kosovës

5.1 KQZ – Sekretariati do ta konsiderojë të pavlefshme dhe nuk do ta numërojë fletëvotimin që është dërguar nga Votimi Jashtë Kosovës:

[...]

(d) pas afatit përfundimtar të parashtruar në nenin 4.4 të kësaj rregulle zgjedhore.

Pranueshmëria e kërkesës

74. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

75. Në këtë drejtim, Gjykata, duke aplikuar nenin 113 të Kushtetutës, dispozitat relevante të Ligjit për sa i përket procedurës në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës; dhe rregullin 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] e rregullin 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës, do të shqyrtojë nëse: (i) kërkesa është dorëzuar nga një palë e autorizuar; (ii) kontestohen vendime të autoriteteve publike; (iii) janë shteruar të gjitha mjetet juridike; (iv) janë saktësuar të drejtat dhe liritë të cilat pretendohet se janë shkelur; (v) janë respektuar afatet kohore; (vi) kërkesa është qartazi e pabazuar; dhe (vii) ka ndonjë kriter shtesë të pranueshmërisë, sipas rregullit 39 (3) të Rregullores së punës, që nuk është plotësuar.

Lidhur me palët e autorizuara

76. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

77. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

78. Gjykata në fund i referohet edhe pikës (a) të paragrafit (1) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës i cili përcakton:

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar.

79. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave për palët e autorizuara, Gjykata vëren se para Gjykatës paraqitet Koalicioni "NISMA-AKR-PD", i cili ka marrë pjesë si koalicion dhe është regjistruar si i tillë në KQZ për të garuar në zgjedhjet e 6 tetorit 2019 për Kuvend. Kërkesa është paraqitur nga i autorizuari i Kolicionit në fjalë, sipas autorizimit të dhënë nga Kryetari i Partisë NISMA Socialdemokrate, si bartës i listës/udhëheqës i Koalicionit "NISMA-AKR-PD".

80. Gjykata vëren se, në bazë të nenit 21.4 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të parashtrojë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në të drejtat kushtetuese që vlejnë për personat juridikë, për aq sa ato janë të zbatueshme (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, Parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës,* Aktgjykim i 21 janarit 2019, paragrafi 101; KI41/09, parashtrues *AAB-RIINVEST University L.L.C.,* Aktvendim për papranueshmëri i 21 janarit 2010; shih po ashtu, rastin e GJEDNJ-së, *Partia për një Shoqëri Demokratike dhe të tjerët kundër Turqisë,* nr. 3840/10, Aktgjykim i 12 janarit 2016).

81. Për më tepër, dhe në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu thekson se GJEDNJ-ja, nëpërmjet praktikës së saj gjyqësore, ka konstatuar se e drejta për t'u zgjedhur në kuadër të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, është e drejtë që u garantohet edhe partive politike, si subjekte juridike, dhe se ato mund të ankohen pavarësisht nga kandidatët e tyre (shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, *Partia e Punës së Gjeorgjisë kundër Gjeorgjisë,* nr. 9103/04, Aktgjykim i 8

korrikut 2008, paragrafët 72-74, dhe referencat e tjera të përmendura në atë vendim).

82. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Koalicioni "NISMA-AKR-PD", megjithëse nuk kanë qenë palë në procedurat para Gjykatës Supreme që kanë rezultuar në nxerrjen e vendimeve të kontestuara, ky Koalicion ka kontestuar kushtetutshmërinë e dy vendimeve të Gjykatës Supreme në cilësi të palës së interesuar. Statusin e palës në procedurë parashtruesi i kësaj kërkese e ka fituar në momentin që vendimmarrja e Gjykatës Supreme, që ishte në favor të kërkesës së LVV, dhe që kishte rezultuar në vendime të ndryshme në krahasim me vendimet e KQZ dhe PZAP, kishte mundësi të ndikonte në të drejtat pasive zgjedhore të këtij Koalicioni që mbrohen me nenin 45 të Kushtetutës dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Gjykata gjithashtu potencon faktin se përveç parashtrimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës nuk kishte ndonjë mjet tjetër juridik në dispozicion për të kontestuar vendimet e Gjykatës Supreme, të cilat potencialisht, përveç në të drejtat e parashtruesit të kërkesës, do të mund të kishin efekt edhe në të drejtat e subjekteve të tjera, qofshin ata individë, koalicione, parti politike ose të ngjashme.

83. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është dorëzuar nga një palë e autorizuar që ka interes direkt në kushtetutshmërinë e vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme në aspekt të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

Lidhur me aktin e autoritetit publik

84. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cituar më lart, dhe nenit 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit, i cili përcakton se "*Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. [...]*".

85. Gjykata gjithashtu i referohet edhe paragrafit (2) të rregullit 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës i cili, *inter alia*, përcakton se "*(2) Kërkesa, e bërë sipas këtij rregulli duhet të qartësojë saktësisht [...] cili është akti konkret i autoriteti publik i cili kontestohet*".

86. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i konteston dy akte të një autoriteti publik, përkatësisht dy vendime të Gjykatës

Supreme: (i) Aktgjykimin A.A.U.ZH.nr.20/2019 të 30 tetorit 2019; dhe, (ii) Aktgjykimin A.A.U.ZH.nr.21/2019 të 5 nëntorit 2019.

87. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës konteston akte të një autoriteti publik.

Lidhur me shterimin e mjeteve juridike

88. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cituar më lart; paragrafit 2 të nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit; dhe pikës (b), paragrafit (1), të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

(...)

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(...)

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuara.

89. Gjykata vëren që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës përcakton detyrimin e shterimit të *"të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj"*. Ky detyrim kushtetues është gjithashtu i përcaktuar me nenin 47 të Ligjit dhe me pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe vlen, si për personat fizikë ashtu edhe për personat juridikë, për aq sa është e aplikueshme.

90. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të vërtetojë nëse janë shterur të gjitha mjetet juridike nga ana e parashtruesit të kërkesës, në cilësi të

Koalicionit NISMA-AKR-PD, me të cilin kanë marrë pjesë në zgjedhjet e 6 tetorit 2019.

91. Gjykata rikujton se LVV në përgjigjen e saj lidhur me kërkesën pretendon se parashtruesi i kërkesës nuk ka shterur mjetet juridike pasi sipas tyre ata nuk kanë bërë ankesë në Gjykatën Supreme, *"në përputhje me legjislacionin zgjedhor në fuqi, me pretendimin e shkeljeve të caktuara kushtetuese*".

92. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se palët e autorizuara kanë të drejtë të kontestojnë vetëm aktet individuale të autoriteteve publike që cenojnë të drejtat e tyre individuale dhe vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike, të përcaktuara me paragrafin 7, të nenit 113 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI102/17, parashtrues: *Meleq Imeri,* Aktvendim për papranueshmëri, i 10 janarit 2018, paragrafi 20).

93. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se vendimet e KQZ-së dhe PZAP-së, që i kanë paraprirë vendimeve të kontestuara kanë qenë në favor të parashtruesit të kërkesës dhe se parashtruesi i kërkesës, nuk ka konsideruar se është viktimë e atyre vendimeve në mënyrë që të paraqesë ankesë në Gjykatës Supreme. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk ka përdorur ndonjë mjet juridik kundër vendimeve të KQZ-së dhe PZAP-së para Gjykatës Supreme. Ndërsa, lidhur me vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme, siç u tha edhe më lart, parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur në dispozicion ndonjë mjet tjetër juridik të paraparë me ligj, para Gjykatës Supreme apo ndonjë institucioni tjetër. Rrjedhimisht, pretendimi i LVV-së për mos-shterjen e mjeteve juridike nga parashtruesi i kërkesës nuk është i bazuar.

94. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh këto që u thanë më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për të kontestuar vendimet e kontestuara para Gjykatës.

Lidhur me saktësimin e kërkesës dhe afatin

95. Në vazhdim, Gjykata po ashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë, të përcaktuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. (...)

96. Gjykata rikujton që të njëjtat kritere janë të specifikuara më tej në pikat (c) dhe (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] dhe paragrafët (2) dhe (4) të rregullit 76 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit] të Rregullores së punës.

97. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ pretendon se i janë cenuar dhe i ka specifikuar aktet konkrete të autoritetit publik të cilët i konteston në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe dispozitat përkatëse të Rregullores së punës dhe e ka parashtruar kërkesën brenda afatit prej katër (4) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe dispozitat përkatëse të Rregullores së punës.

98. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka saktësuar kërkesën e tij dhe të njejtën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor.

Lidhur me kushtet e tjera të pranueshmërisë

99. Në fund dhe pas shqyrtimit të ankesës kushtetuese të parashtruesve të kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet qartazi e pabazuar në kuadër të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës dhe nuk ka asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme, meqë asnjë nga kushtet e përcaktuara me rregullin 39 (3) të Rregullores së punës nuk janë të aplikueshme në rastin konkret (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, paragrafi 144; shih, po ashtu,

rastin e Gjykatës Kushtetuese KI48/18, parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 115).

Konkluzion lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

100. Gjykata arrin në përfundimin se parashtruesi i kërkesës: (i) është palë e autorizuar; (ii) i konteston dy vendime të një autoriteti publik; (iii) i ka shteruar mjetet juridike siç është elaboruar specifikisht më lart; (iv) i ka saktësuar të drejtat dhe liritë të cilat pretendon se janë shkelur; (v) e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit; (vi) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar; dhe se (vi) nuk ka asnjë kusht tjetër të pranueshmërisë i cili nuk është plotësuar.

101. Rrjedhimisht, Gjykata e shpallë kërkesën të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

Meritat e kërkesës

102. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme, respektivisht Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.20/2019] të 30 tetorit 2019 dhe Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.21/2019] të 5 nëntorit 2019. Parashtruesi i kërkesës, Koalicioni "NISMA-AKR-PD", pretendon se Gjykata Supreme, përmes këtyre dy vendimeve, ka vepruar në kundërshtim: *(i)* me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës; *(ii)* paragrafin 1 të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenin 6 (E drejta për gjykim të drejtë) të KEDNJ; dhe, *(iii)* nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira), të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

103. Megjithatë, përveç kontestimit të kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara si pasojë e shkeljeve të pretenduara të të drejtave zgjedhore dhe të drejtës për një gjykim të drejtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme në kundërshtim me Kushtetutën ka vendosur të aplikojë drejtpërdrejt instrumentet ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës dhe jo nenin 96.2 të LZP-së dhe nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013.

104. Rrjedhimisht, para se të trajtojë çështjet që ndërlidhen me shkeljet e pretenduara lidhur me të drejtat zgjedhore dhe të drejtën për një gjykim të drejtë lidhur me vendimet e kontesutara, Gjykata e sheh të nevojshme që, si çështje paraprake, të trajtojë çështjen që parashtruesi i kërkesës ngrit lidhur me statusin e instrumenteve ndërkombëtare të

përfshira në nenin 22 të Kushtetutës në sistemin juridik të Kosovës, si dhe faktin nëse gjykatat e rregullta: *i)* kanë të drejtë të aplikojnë drejtpërdrejt normat kushtetuese dhe/ose instrumentet ndërkombëtare të parapara në nenin 22 të Kushtetutës, si dhe të interpretojnë normat ligjore në harmoni dhe sipas obligimeve që dalin nga normat kushtetuese, apo *ii)* nëse në raste të tilla ato kanë për obligim që sipas nenit 113.8 të Kushtetutës, të referojnë çështjen në Gjykatë Kushtetuese sa herë që ngritët çështja e kushtetutshmërisë së normave juridike.

Statusi i instrumenteve ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës në sistemin juridik të Kosovës

105. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se instrumentet ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës kanë fuqinë e normave kushtetuese dhe dallojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara sipas Kushtetutës, procedurë e cila bëhet përmes miratimit të ligjit për ratifikimin e marrëveshjeve.

106. Gjykata i referohet nenit 22 të Kushtetutës, lidhur me zbatimin e drejtpërdrejt të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, që specifikon se: *"të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare* [të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës], *garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike […]"*.

107. Gjykata rikujton edhe praktikën e saj gjyqësore ku kishte theksuar se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të garantuara me instrumentet ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe janë pjesë e rendit juridik të Republikës së Kosovës (shih, në mes tjerash, rastin nr. KO162/18, parashtrues: *Kryetari i Kuvendit të Republikës* së *Kosovës,* Aktgjykim i 19 dhjetorit 2018, paragrafi 36).

108. Rrjedhimisht, sipas nenit 22 të Kushtetutës, Republika e Kosovës jo vetëm që ka pranuar që KEDNJ dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës janë të zbatueshme drejtpërdrejt në rendin e saj të brendshëm ligjor, por, ajo gjithashtu e ka paraparë me Kushtetutë që, në rast konflikti, KEDNJ, aq sa edhe të shtatë (7) instrumentet e tjera ndërkombëtare të referuara në nenin 22, kanë epërsi ndaj ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike të Kosovës.

109. Për më tepër, sipas nenit 53 të Kushtetutës, gjykatat e Republikës së Kosovës, të gjitha pa përjashtim, e kanë për obligim që të interpretojnë *"Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me këtë Kushtetutë sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*. Kjo do të thotë që, në të gjitha instancat kur Gjykata Kushtetuese ose gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës i interpretojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë, standardet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të zbatohen për këto të drejta dhe liri, kur kjo është e zbatueshme. Në rast konflikti midis të dyjave, standardet e vendosura nga GJEDNJ në interpretimin e KEDNJ-së do të mbizotërojnë.

110. Gjithashtu, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së paraqet burim nga i cili derivojnë të drejta për interpretim të të drejtave dhe lirive të njeriut në pajtim me mënyrën se si zhvillohet ajo praktikë gjyqësore – sipas konceptit që KEDNJ-së është një "instrument i gjallë" (*"living document"*) në zhvillim e sipër. Në praktikë, kjo nënkupton që, përveç se qytetarët e Republikës së Kosovës mund të thirren në nenet specifike të instrumenteve ndërkombëtare të garantuara me nenin 22 të Kushtetutës, ata mund të thirren edhe në rastet specifike të trajtuara në nivel të GJEDNJ-së, me qëllim të argumentimit të kërkesave të tyre për mbrojte të lirive dhe të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë.

111. Andaj, si përfundim, përkundër faktit dhe pretendimit të parashtruesit të kërkesës që Kosova nuk është nënshkruese e instrumenteve ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës, sipas asaj që u tha më lart, Gjykata ripërtëritë qëndrimin e saj se të drejtat dhe liritë e garantuara me instrumentet ndërkombëtare të referuara në nenin 22 të Kushtetutës kanë statusin e normave të rangut kushtetues dhe janë pjesë përbërëse e Kushtetutës, në të njëjtën mënyrë sikurse të gjitha dispozitat e tjera të përfshira në Kushtetutë.

Të drejtat dhe obligimet e gjykatave të rregullta në fushën e aplikimit të drejtpërdrejt të normave kushtetuese

112. Në këtë aspekt, Gjykata do të përgjigjet në pyetjet nëse gjykatat e rregullta kanë të drejtë i) të aplikojnë drejtpërdrejt normat kushtetuese dhe/ose instrumentet ndërkombëtare sipas nenin 22 të Kushtetutës si dhe të interpretojnë normat ligjore në harmoni dhe sipas obligimeve që dalin nga normat kushtetuese, apo ii) janë të obliguara që sipas nenit 113.8 të Kushtetutës, të referojnë çështjen në

Gjykatën Kushtetuese sa herë që ngritët çështja e kushtetutshmërisë së normave juridike.

113. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, pasi argumenton se të drejtat e njeriut të garantuara me instrumentet ndërkombëtare dhe të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës konsiderohen norma kushtetuese, me të cilin interpretim pajtohet edhe Gjykata, parashtruesi vijon pretendimin e tij se normat kushtetuese nuk janë të vet-ekzekutueshme dhe se normat kushtetuese, për dallim prej ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, duke përfshirë edhe të drejtat e njeriut të garantuara me instrumentet ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës, jetësohen vetëm përmes ligjeve. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta janë të obliguara të zbatojnë ligjet dhe jo drejtpërdrejt Kushtetutën dhe normat e saj.

114. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës mban qëndrimin se gjykatat e rregullta *"janë të obliguara"* të referojnë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 113.8 të Kushtetutës, sa herë që konsiderohet se një ligj nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

115. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se ekzistojnë praktika të ndryshme se si sistemet juridike të vendeve të tjera rregullojnë çështjen e kontrollit kushtetues të normave juridike. Sipas një studimi të Komisionit të Venecias, sistemet juridike të anëtarëve të Komisionit të Venecias ndahen në grupe të caktuara kur bie fjala tek çështja e kontrollit kushtetues të normave juridike. Lidhur me përcaktimin se cili sistem i kontrollit të kushtetutshmërisë zbatohet në vende të ndryshme, studimi në fjalë thekson se, klasifikimi i një sistemi juridik si "i shpërndarë" në njërën anë, apo si i "koncentruar" në anën tjetër është i vështirë dhe se, rrjedhimisht, natyra e sistemit juridik përcaktohet nga kompetencat materiale të gjykatave specifike brenda sistemit të caktuar (shih më gjerësisht lidhur me këtë aspekt, *Studimin për Qasjen e Individëve në Drejtësinë Kushtetuese,* miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e 85-të Plenare 17-18 dhjetor 2010, CDL-AD(2010)039rev, faqe 12).

116. Duke u bazuar në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Gjykata në vazhdim do të trajtojë *i)* rolin e gjykatave tona të rregullta në aplikimin e normave kushtetuese dhe nëse gjykatat e rregullta mund të interpretojnë normat kushtetuese; dhe *ii)* nëse gjykatat e rregullta, kur konsiderojnë së një normë ligjore nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën, mund të shmangin zbatimin e një ligji që e konsiderojnë jo-kushtetues/interpretojnë atë në harmoni me

Kushtetutën apo në rast se ngritët çështja e kushtetutshmërisë së normave ligjore, janë të obliguara të referojnë çështjen në Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 113.8 të Kushtetutës.

117. Gjykata do të bëjë këtë interpretim duke u bazuar në dispozitat konkrete të Kushtetutës së vendit.

Nëse Gjykata Kushtetuese është autoriteti i vetëm në Republikën e Kosovës për të interpretuar Kushtetutën

118. Gjykata fillimisht sqaron hierarkinë e normave juridike dhe rolin e gjykatave të rregullta në zbatimin e drejtpërdrejt të normave kushtetuese, sipas dispozitave të Kushtetutës. Lidhur me këtë Gjykata fillimisht i referohet nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] që përcakton se: *"1.Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë. [...]"*.

119. Gjykata i referohet, edhe njëherë nenit 22 të Kushtetutës, lidhur me zbatimin e drejtpërdrejt të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare që përdorë formulim të ngjashëm, sikurse neni 16 i Kushtetutës, duke theksuar se: *"të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare* [të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës], *garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike [...]"*.

120. Nga dispozitat e lartcekura të Kushtetutës, është e qartë se Kushtetuta është akti më i lartë juridik në Kosovë dhe se të gjitha normat tjera ligjore duhet të jenë në pajtueshmëri me të. Një konstatim i tillë është shprehur dhe mbështetur tashmë edhe nga praktika gjyqësore e kësaj Gjykate. Më specifikisht, në këtë aspekt Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore ku kishte konstatuar se nenet kushtetuese të lartreferuara garantojnë parimin e "*supremacisë kushtetuese*", sipas të cilit Kushtetuta, në aspekt hierarkik, qëndron në krye të piramidës dhe është burim i të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore në Republikës e Kosovës. Në këtë të fundit, "*supremacia*" e Kushtetutës po ashtu sigurohet përmes aplikimit të mekanizmit të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe verifikimit të përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën, gjithnjë sipas mënyrës së përcaktuar me Kushtetutë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI48/18, parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 182).

121. Lidhur me rolin e gjykatave të rregullta në zbatimin e drejtpërdrejt të normave kushtetuese, Gjykata rikujton përmbajtjen e nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës që përcakton se:

"1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.
[...]
3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.
[...]."

122. Gjykata po ashtu rikujton nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës që përcakton se:

"1.Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.
[...]."

123. Gjykata gjithashtu i referohet edhe nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës që përcakton se:

"1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.
[...]
3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.
[...]."

124. Bazuar në dispozitat kushtetuese të cekura më lart, rezulton që gjykatat e rregullta kanë të drejtë dhe për më tepër obligim që gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjykojnë, fillimisht sipas Kushtetutës, e pastaj sipas ligjit.

125. Gjithashtu, duke pasur parasysh hierarkinë e normave ligjore që u sqarua më lart, që Kushtetuta është akti më i lartë juridik në Kosovë dhe se ligjet dhe aktet tjera duhet të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën, Gjykata thekson se gjykatat e rregullta janë të obliguara që të interpretojnë normat ligjore në harmoni me normat kushtetuese.

126. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se roli i gjykatave të rregullta në interpretimin e Kushtetutës nuk ndikon në juridiksionin dhe

autorizimet që i janë dhënë Gjykatës Kushtetuese sipas 112 të Kushtetutës, si autoritetit përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

127. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se Gjykata Kushtetuese sipas Kushtetutës është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës. Përmbajtja e nenit 112 të Kushtetutës, cituar më lart, dërgon në përfundimin e qartë se Gjykata Kushtetuese është organ publik me autorizim ekskluziv kushtetues për të interpretuar përfundimisht Kushtetutën dhe për të interpretuar përfundimisht përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën – gjë që nënkupton se para saj edhe autoritetet e tjera publike mund të angazhohen në interpretim kushtetues. Megjithatë, mënyra e interpretimit, si për nga procedura ashtu edhe për nga substanca, që autoritet e tjera publike, duke përfshirë gjykatat e rregullta i kanë bërë Kushtetutës, gjithmonë mund të kontestohet para Gjykatës Kushtetuese. Në ato rrethana, Gjykata Kushtetuese do të jap interpretimin përfundimtar duke u pajtuar apo duke mos u pajtuar me interpretimin që i është bërë Kushtetutës paraprakisht.

128. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore ku kishte konstatuar se *"përtej Gjykatës Kushtetuese, është po ashtu detyrim i gjykatave të rregullta që përgjatë vlerësimit të shkeljeve të pretenduara të interpretojnë edhe të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Ky detyrim buron nga: (i) neni 21 [Parimet e Përgjithshme] i Kushtetutës, sipas të cilit, ndër të tjera, liritë themelore të njeriut janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtyre të drejtave hyjnë edhe ato të garantuara me marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës; dhe (ii) neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] i Kushtetutës, sipas të cilit gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit. Rrjedhimisht, të drejtat e garantuara me Kushtetutë mbrohen nga të gjitha instancat gjyqësore dhe Gjykata Kushtetuese, e cila mbi bazën e nenit 112 të Kushtetutës, është autoriteti përfundimtar i vlerësimit të shkeljeve të pretenduara nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë."* (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI48/18, parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës,* cituar më lart, paragrafi 181.)

129. Pra, sipas interpretimit të nenit 102.3 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 112.1 të Kushtetutës si dhe sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit vlerëson që e drejta dhe obligimi për të aplikuar dhe interpretuar Kushtetutën, iu njihet të gjitha gjykatave të

Republikës së Kosovës. Këto të fundit, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme si instancë më të lartë gjyqësore në nivel të Republikës, kanë për obligim të interpretojnë ligjet në harmoni me Kushtetutën.

130. Si përfundim, Kushtetuta, autorizimin për të interpretuar Kushtetutën si dhe autorizimin për të interpretuar ligjet në pajtim me Kushtetutën ua njeh të gjitha gjykatave dhe autoriteteve të tjera publike në Republikën e Kosovës. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese është autoriteti i vetëm në Republikën e Kosovës me autorizim ekskluziv kushtetues për të shfuqizuar një ligj ose normë ligjore si dhe për të bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me të.

Nëse gjykatat e rregullta janë të obliguara të referojnë çështjen e kushtetutshmërisë së ligjeve në Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 113, paragrafit 8 të Kushtetutës

131. Lidhur me këtë, Gjykata po ashtu rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës se "*kur gjykatat vijnë deri te një konstatim se ligji apo norma që duhet ta zbatojnë është kundër kushtetuese, atëherë ato kanë autorizimin e vetëm për të iniciuar procedurat e kontrollit incidental, sipas nenit 113.8 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës*".

132. Në vazhdim Gjykata do të trajtojë pretendimin e parashtruesit se gjykatat e rregullta kanë për obligim që, sa herë që ngritët çështja e kushtetutshmërisë së normave ligjore, të referojnë çështjen në Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 113.8 të Kushtetutës, dhe jo të shmangin aplikimin e një ligji që e konsiderojnë jokushtetues.

133. Lidhur me këtë, Gjykata e konsideron të nevojshme që të bëjë edhe një herë interpretimin e paragrafin 8 të nenit 113 të Kushtetutës, dhe obligimet që dalin nga këto dispozita. Paragrafi 8 i nenit 113 të Kushtetutës përcakton se:

"Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë."

134. Gjykata, për qëllime të adresimit të pretendimit të parashtruesit do të ndalet tek pjesa e parë e paragrafit 8 të nenit 113 të Kushtetutës që

thekson se: *"Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji [...]"*.

135. Sipas këtij kriteri, Gjykata vëren se Kushtetuta në mënyrë të qartë parasheh se gjykatat e rregullta *"kanë të drejtë"* të referojnë çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji. Mirëpo, Kushtetuta në asnjë mënyrë nuk i obligon gjykatat e rregullta që patjetër t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese sa herë që mund të lind një pyetje e tillë në nivel të gjykatës së rregullt. Kjo qartazi nënkupton që e drejta e gjykatave të rregullta për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese është e drejtë diskrecionale dhe jo një obligim detyrues kushtetues. Po të ishte obligim, siç pretendon parashtruesi i kërkesës, Kushtetuta do ta parashihte qartë këtë si obligim për gjykatat e rregullta.

136. Kushtetuta përcakton që gjykata e rregullta kanë "të drejtë", në rast "dyshimi", por jo edhe "obligim" që të referojnë çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji në Gjykatën Kushtetuese.

137. Rrjedhimisht, Gjykata sqaron se, lidhur me përputhshmërinë e normave ligjore me normat kushtetuese, nëse një çështje kushtetuese ngritët në rastet para gjykatave të rregullta, sipas nenit 113.8 të Kushtetutës, dhe kur gjykatat e rregullta nuk janë të sigurta për kushtetutshmërinë e normës ligjore, pra kanë "dyshime" rreth kushtetutshmërisë së tyre, ato mund të referojnë rastin para Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 113.8 të Kushtetutës – por që nuk kanë obligim kushtetutes që patjetër ta bëjnë një gjë të tillë. Në anën tjetër, Gjykata mund të vendos të mos referojë një çështje në Gjykatën Kushtetuese kur në rastin konkret, mund të inerpretojë atë normë në harmoni me Kushtetutën apo të aplikojë drejtpërdrejt normën kushtetuese. Në këtë rast, gjykata e rregullt që ka rastin para saj, me arsyetim të mjaftueshëm e adekuat, mund të zbatojë drejtpërdrejt normën e rangut kushtetues dhe të lë mënjanë normën e rangut ligjor për rastin konkret që ka para saj.

138. Megjithatë, Gjykata gjithashtu thekson, duke u bazuar në rolin e Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 112 të Kushtetutës, në rastet kur gjykatat e rregullta zgjedhin të mos referojnë një çështje sipas nenit 113.8 të Kushtetutës, i takon Gjykatës Kushtetuese, siç do të veprojë në këtë rast, të vlerësojë si autoritet përfundimtar, pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike efektive të parapara me ligj, nëse interpretimi i normave kushtetuese i bërë nga gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre, është në pajtueshmëri me Kushtetutën. Kjo nënkupton që arsyetimi i dhënë nga gjykatat e rregullta për lënien mënjanë të normës së rangut ligjor në favor të aplikimit të normës së rangut

kushtetutes është i një rëndësie të lartë për faktin se vendimmarrja e tillë duhet të jetë bindëse dhe e saktë ashtu që të mund të konfirmohet përfundimisht nga Gjykata Kushtetuese – në rast se rasti paraqitet para saj.

139. Është e rëndësishme të theksohet se interpretimi i normave kushtetuese, duke përfshirë edhe të drejtën e gjykatave të rregullta që vendosin në një rast konkret, për të zbatuar një normë ligjore në harmoni me normën kushtetuese dhe/ose zbatimin e drejtpërdrejtë të nomës kushtetuese, duhet dalluar nga e drejta për të shfuqizuar norma ligjore të cilat konsiderohen se nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën. Ekziston një dallim i thellë dhe i rëndësishëm, në njërën anë, në mes të interepretimit të një norme të rangut ligjor në harmoni me një normë të rangut kushtetues dhe/ose zbatimin e drejtëdrejtë të një norme kushtetuese; dhe, në anën tjetër, të "shfuqizimit" të një norme ligjore si normë në kundërshtim me një normë kushtetuese, me efekt *erga omnes*.

140. Përderisa Kushtetuta ia njeh gjykatave të rregullta kompetencën e interpretimit të një norme ligjore në harmoni me një normë kushtetuese dhe/ose aplikimin e drejtëdrejtë të nomës kushtetuese, kompetencën e "shfuqizimit" të normave ligjore si të papajtueshme me Kushtetutën, kjo e fundit nuk e ka paraparë si kompetencë për gjykatat e rregullta.

141. Kushtetuta e Kosovës ka paraparë në mënyrë specifike procedurën, mënyrën dhe institucionin që ka autorizim ekskluziv kushtetues që të konstatojë përfundimisht kundërkushtetutshmërinë e një normë ligjore dhe shfuqizimin e saj në rast se ajo është në kundërshtim me Kushtetutën. Këtë të drejtë Kushtetuta ia ka mveshur vetëm Gjykatës Kushtetuese e cila mund, pas paraqitjes së kërkesës nga një palë e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës, të konstatojë përfundimisht kundërkushtetutshmërinë e normës dhe ta shfuqizojë atë normë që është në kundërshtim me Kushtetutën, duke përcaktuar gjithashtu efektet e një shfuqizimi të tillë.

142. Në dritën e rrethanave të rastit konkret, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta kanë autorizim kushtetues që të aplikojnë një normë ligjore në harmoni me Kushtetutën apo të aplikojnë drejtërejtë një normë të vetzbatueshme kushtetuese, duke përfshirë edhe konventat ndërkombëtare që janë pjesë përbërëse e Kushtetutës sipas nenit 22 të Kushtetutës. Në nivel parimor, kjo nënkupton që Gjykata Supreme, në rastin konkret, ka qenë në të drejtën e saj të aplikojë drejtpërdrejt normën e KEDNJ-së. Se a është në përputhje me autorizimet kushtetutese të Gjykatës Supreme konstatimi i kolizionit në fjalë dhe

se a është i saktë interpretimi i saj në rrethanat e rastit konkret, është nën autoritetin e Gjykatës Kushtetutese që të vendosë përfundimisht.

143. Andaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata Kushtetuese duhet të interpretojë dhe vendosë përfundimisht se a janë vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

144. Këtë vlerësim Gjykata do ta bëjë në vijim të këtij Aktgjykimi.

Përputhshmëria e vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

145. Në këtë drejtim, Gjykata do të vlerësojë kushtetutshmërinë e dy vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme, respektivisht Aktgjykimit A.A.U.ZH.nr.20/2019 të 30 tetorit 2019 dhe Aktgjykimit A.A.U.ZH.nr.21/2019 të 5 nëntorit 2019.

146. Për të bërë këtë vlerësim, Gjykata fillimisht do të paraqes obligimet përkitazi me garantimin e votimit nga jashtë që neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së vendosë mbi shtetet që zbatojnë Konventën – gjithnjë sipas interpretimit që GJEDNJ i ka dhënë këtij neni. Më pas, Gjykata do t'i aplikojë ato parime në rrethana të rastit konkret dhe do të bëjë vlerësimin konkret të kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara.

147. Krejt në fund, Gjykata do të adresojë çështjen e masës së përkohshme; do të theksojë efektet e këtij Aktgjykimi si dhe, do të paraqes përfundimet lidhur me këtë rast.

Parimet e përgjithshme të nenit 3 të Protkollit nr. 1 të KEDNJ-së, në veçanti ato përkitazi me "votimin nga jashtë", sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së

148. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht rikujton përmbajtjen e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së që përcakton më sa vijon: *"Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës".*

149. Të drejtat e garantuara me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së janë të drejta qenësore drejt krijimit dhe mbajtjes së themeleve të një demokracie efektive dhe të vlefshme që udhëhiqet nga sundimi i ligjit. Megjithatë, këto të drejta nuk janë absolute. Ka hapësirë për "kufizime

të nënkuptuara" dhe shteteve duhet tu jepet margjinë e gjerë vlerësimi në këtë aspekt (shih rastin e GJEDNJ-së, *Yumak dhe Sadak kundër Turqisë*, Aktgjykim i 8 korrikut 2008, paragrafi 109 dhe referencat e cituara aty).

150. Në këtë aspekt, GJEDNJ ka qartësuar se neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dallon nga nenet e tjera të KEDNJ-së dhe Protokollëve të saj ngase është i formuluar në aspekt të "obligimit" që shtetet kanë për të organizuar zgjedhje të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve – e jo në aspekt të një "të drejte apo lirie" të caktuar. Megjithatë, duke marrë për bazë punët përgatitore në hartimin e kësaj norme dhe interpretimin e saj në kontekst të KEDNJ-së si tërësi, GJEDNJ-ja ka gjetur se edhe kjo dispozitë ngërthen "të drejta individuale", që përfshijnë "të drejtën e votës" (aspekti aktiv) dhe "të drejtën për tu zgjedhur" (aspekti pasiv) (shih *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgium*, 1987, paragrafët 48-51; *Ždanoka kundër Letonisë*, Aktgjykimi i DHM të GJEDNJ i 16 marsit 2006, paragrafi 102; shih, *mutatis mutandis,* rastet e Gjykatës Kushtetuese KI01/18, parashtrues *Gani Dreshaj dhe AAK*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2019, paragrafët 99-102 ku në mes tjerash shpjegohen edhe parimet e tjera ndërlidhëse të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në të cilat thirret Gjykata).

151. Aspekti aktiv dhe pasiv i votës ngërthejnë në vetvete garanci substanciale dhe procedurale. Megjithatë, Gjykata vëren që, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të drejtat pasive janë pajisur me më pak mbrojtje sesa të drejtat aktive (shih rastin e GJEDNJ-së, *Zdanoka kundër Latvisë*, nr. 58278/00, Aktgjykim i 16 marsit 2006, paragrafët 105-106). Praktika e GJEDNJ-së, në raport me të drejtat pasive është fokusuar dukshëm vetëm në verifikimin e mungesës së arbitraritetit në procedurat vendëse e që mund të kenë rezultuar në diskualifikimin e një personi fizik apo juridik për të kandiduar në zgjedhje (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI01/18, *parashtrues Gani Dreshaj dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)*, Aktgjykim i 23 janarit 2019, dhe referencat e tjera të cituara aty).

152. Të drejtat e garantuara sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së janë thelbësore për krijimin dhe mbajtjen e themeleve të një demokracie efektive dhe kuptimplote të qeverisur nga sundimi i ligjit. Sidoqoftë, këto të drejta nuk janë absolute. Ka hapësirë për "kufizime të nënkuptuara", dhe Shteteve Kontraktuese duhet t'u jepet një hapësirë e vlerësimit në këtë sferë. GJEDNJ riafirmon se hapësira në këtë fushë është e gjerë (shih, rastin *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt*, cituar më lart, paragrafi 52, *Matthews,* cituar më lart, paragrafi 63, *Labita*, cituar më lart, paragrafi 201 dhe *Podkolzina kundër Letonisë*,

nr. 46726 / 99, paragrafi 33, GJEDNJ 2002-II). Ekzistojnë mënyra të shumta për organizimin dhe drejtimin e sistemeve zgjedhore dhe një mori dallimesh, ndër të tjera, në zhvillimin historik, diversitetin kulturor dhe mendimin politik brenda Evropës, që secili Shtet Kontraktues duhet ta fusë në vizionin e vet demokratik (shih, rastin *Hirst kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 2) [DHM], nr. 74025/01, paragrafi 61, GJEDNJ 2005-IX, shih gjitashtu, rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI01/18, parashtrues *Gani Dreshaj dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës*; dhe KI48/18, parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës,* të dy aktgjykime të cituara më lart).

153. Gjithashtu, GJEDNJ ka qartësuar se si nen me karakteristika të veçanta, neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk përmban një listë të qëllimeve legjitime të cilat do të justifikonin kufizimin e ushtrimit të së drejtës që garantohet me këtë nen. I njëjti gjithashtu nuk iu referohet "qëllimeve legjitime" të cilat në mënyrë shterruese janë të përcaktuara në nenet 8 deri 11 të KEDNJ-së. Si rezultat, GJEDNJ ka theksuar se shtetet janë të lira të thirren në "qëllimet e tyre" specifike kur kufizojnë ushtrimin e kësaj të drejte me kushtin që qëllimet e tilla të jenë: (i) në pajtim me parimin e sundimit të ligjit; dhe (ii) objektivave të përgjithshme të Konventës (shih *Ždanoka kundër Letonisë*, cituar më lart, paragrafi 115).

154. GJEDNJ e ka interpretuar këtë nen të KEDNJ-së edhe në një mori rastesh të tjera që ndërlidhen me zgjedhjet. Megjithatë, në vijim Gjykata do të fokusohet në rastet e GJEDNJ-së që ndërlidhen ekskluzivisht me "votimin nga jashtë" – si çështje kryesore në këtë rast zgjedhor pranë kësaj Gjykate.

155. Ndër rastet kyçe të GJEDNJ-së, që diskuton çështjen e votimit nga jashtë është rasti *Sitaropoulos dhe Giakoumopoulos kundër Greqisë* (shih kërkesa nr. 42202/07, Aktgjykim i DHM të GJEDNJ-së i 15 marsit 2012 – shih po ashtu rastet e tjera të GJEDNJ-së cituar aty). Ndonëse ky rast nuk është identik për nga faktet me rastin të cilin Gjykata e ka në shqyrtim; megjithatë, parimet e vendosura aty përkitazi me votimin nga jashtë qëndrojnë dhe, *mutatis mutandis,* mund të aplikohen për rrethanat e rastit konkret në dritën e nxjerrjes së përfundimit se çfarë obligimi vendos mbi shtetet neni 3 i Protkollit nr. 1 të KEDNJ-së në raport me votimin nga jashtë. Sipas interpretimeve të GJEDNJ-së në këtë rast dhe disa raste të tjera, neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk i obligon shtetet që të krijojnë një sistem që siguron ushtrimin e të drejtës së votës për shtetasit jo-rezident (për detaje shtesë shih: Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (i qasshëm edhe në gjuhën shqipe dhe serbe), të përditësuar më 30 gusht 2020, faqe 10-13, rastet e

cituara aty dhe specifikisht pjesën e titulluar *"3. Organizimi i zgjedhjeve jashtë për jo-rezidentët"*).

156. Rasti *Sitaropoulos dhe Giakoumopoulos kundër Greqisë* (cituar më lart) ishte dorëzuar në GJEDNJ nga tre shtetas grekë të cilët pretendonin se pamundësia që ata të votonin për zgjedhje parlamentare në Greqi nga vendi i tyre i rezidencës (Strasburg, Francë – ku jetonin dhe punonin në organizatën e Këshillit të Evropës) konsistonte në ndërhyrje joproporcionale me ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Pra, ata ishin shtetas grek me rezidencë në Francë dhe nuk kishin mundësi të ushtronin të drejën e tyre të votës nga jashtë për zgjedhje parlamentare në Greqi. Pamundësinë e ushtrimit të kësaj të drejte parashtruesit e konsideronin shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Siç do të shpjegohet në vijim, GJEDNJ nuk kishte gjetur shkelje në këtë rast duke arritur në përfundimin se mos ofrimi i mundësisë për votim nga jashtë (ndonëse i inkurajueshëm nga organet e Këshillit të Evropës) nuk shkelë thelbin e të drejtës së votës.

157. Për vlerësimin e këtij pretendimi specifik, GJEDNJ citoi praktikën e aplikueshme gjyqësore, të drejtën e aplikueshme ndërkombëtare si dhe paraqiti hulumtimet e bëra në të drejtën krahasuese të vendeve të Këshillit të Evropës. Nga ky hulumtim rezultoi që tridhjetë e shtatë (37) shtete anëtare të Këshillit të Evropës e mundësojnë, në parim, votimin nga jashtë – qoftë përmes stacioneve të votimit jashtë ose përmes postës. Shtatë (7) shtete anëtare të Këshillit të Evropës nuk lejojnë asnjë mënyrë të votimit nga jashtë. Në shumicën e vendeve që e lejojnë votimin nga jashtë, ekziston një procedurë paraprake administrative përmes së cilës personat e interesuar duhet të paraqiten dhe të regjistrohen – bazuar në afatet ligjore që përcaktohen nga shtetet që lejojnë këtë formë të votimit (shih rastin e GJEDNJ-së: *Sitaropoulos dhe Giakoumopoulos kundër Greqisë*, cituar më lart, paragrafët 39-45).

158. Më tutje, GJEDNJ citoi Rezolutën 1459 (2005) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës lidhur me *"Heqjen e ndalesave për të drejtën e votës"*, ku specifikisht theksohet se: *"7. Duke pasur parasysh rëndësinë e së drejtës për të votuar në një shoqëri demokratike, vendet anëtare të Këshillit të Evropës duhet t'u mundësojnë qytetarëve të tyre që jetojnë jashtë vendit të votojnë gjatë zgjedhjeve kombëtare duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e sistemeve të ndryshme zgjedhore. Ato duhet të ndërmarrin masat e duhura për të lehtësuar ushtrimin e këtyre të drejtave të votimit sa më shumë që të jetë e mundur, në veçanti duke marrë parasysh votimin në mungesë (postar), konsullor ose votimin elektronik, në*

përputhje me Rekomandimin Rec (2004) 11 të Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare për standardet ligjore, operacionale dhe teknike për votimin elektronik. Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për këtë qëllim dhe të përmbahen nga vendosja e pengesave të panevojshme në rrugën e ushtrimit efektiv të të drejtave të votimit të shtetasve të huaj që banojnë në territoret e tyre".

159. GJEDNJ iu referua edhe tri materialeve të publikuara nga Komisioni i Venecias.

160. Së pari, GJEDNJ iu referua Kodit të Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore ku thuhet se *"e drejta për të votuar dhe për tu zgjedhur mund ti akordohet shtetasve që jetojnë jashtë (pika I.1.1.c.v.)"*. Pjesa tjetër relevante e Kodit në fjalë përkitazi me votimin nga jashtë parasheh me sa vijon: *"iii. votimi me postë duhet të lejohet vetëm kur shërbimi postar është i sigurt dhe i besueshëm; e drejta për të votuar duke përdorur votat postare mund të kufizohet për njerëzit që janë në spital ose të burgosur ose për personat me lëvizshmëri të zvogëluar ose për zgjedhësit që banojnë jashtë vendit; mashtrimi dhe kërcënimi nuk duhet të jenë të mundshme;"* (shih pika 3.2 e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore).

161. Së dyti, GJEDNJ iu referua Studimit të Komisionit të Venecias nr. 352/2005 që paraqiste një Raport për ligjin zgjedhor dhe administrimin zgjedhor në Evropë ku në pjesën relevante theksohej se:

"Të drejtat e votimit për shtetasit jashtë vendit:

57. Të drejtat e votimit nga jashtë, p.sh. dhënia e të drejtës për të votuar për shtetasit që jetojnë jashtë vendit, janë një fenomen relativisht i ri. Edhe në demokracitë e themeluara për një kohë të gjatë, qytetarëve që jetojnë në vende të huaja nuk iu dha e drejta e votës deri në vitet 1980 (p.sh. Republika Federale e Gjermanisë, Mbretëria e Bashkuar) ose vitet 1990 (p.sh. Kanada, Japonia). Në ndërkohë, megjithatë, shumë demokraci në zhvillim ose të reja në Evropë kanë futur dispozita ligjore për votimin e jashtëm (votim jashtë vendit, votim jashtë shtetit). Megjithëse ende nuk është e zakonshme në Evropë, mund të konsiderohet futja e të drejtave të votimit nga jashtë, nëse nuk është akoma e pranishme. Megjithatë, duhet të zbatohen masa mbrojtëse për të siguruar integritetin e votës... [...]

152. Votimi me postë është i lejuar në disa demokraci të themeluara në Evropën perëndimore, p.sh. Gjermania, Irlanda, Spanja, Zvicra [...] Është përdorur gjithashtu, për shembull, në Bosnjë dhe

Hercegovinë dhe Kosovë për të siguruar përfshirjen maksimale të procesit zgjedhor (CG/BUR (11) 74). Megjithatë, duhet të lejohet vetëm nëse shërbimi postar është i sigurt dhe i besueshëm. Çdo rast individual duhet të vlerësohet nëse mashtrimi dhe manipulimi ka mundur të ndodhë gjatë votimit postar."

162. Së treti, GJEDNJ iu referua Studimit të Komisionit të Venecias nr. 580/2010 që paraqiste një Raport lidhur me votimet jashtë shtetit, e në të cilin theksohej me sa vijon:

"91. Praktikat kombëtare në lidhje me të drejtën e votës së qytetarëve që jetojnë jashtë vendit dhe ushtrimi i saj janë larg të qenit të njëjta në Evropë.

[...]

98. Për ta përmbledhur, ndërsa mohimi i të drejtës për të votuar për qytetarët që jetojnë jashtë vendit ose vendosja e kufijve në atë të drejtë përbën një kufizim të parimit të votimit universal, Komisioni nuk konsideron në këtë fazë që parimet e trashëgimisë zgjedhore evropiane kërkojnë futjen e një të drejte të tillë.

99. Megjithëse futja e së drejtës për të votuar për qytetarët që jetojnë jashtë vendit nuk kërkohet me parimet e trashëgimisë zgjedhore evropiane, Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit sugjeron që Shtetet, në funksion të lëvizjes evropiane të qytetarëve, dhe në përputhje me situatat e shteteve të caktuara, të miratojnë një qasje pozitive për të drejtën e votës së qytetarëve që jetojnë jashtë vendit, pasi kjo e drejtë nxit zhvillimin e shtetësisë kombëtare dhe evropiane."

163. Pas shqyrtimit të këtyre materialeve (të cilave iu referohet edhe kjo Gjykatë), GJEDNJ arriti në përfundimin se *"asnjë nga instrumentet ligjore të ekzaminuara më sipër nuk formojnë një bazë për të arritur në përfundimin se, ashtu si qëndron gjendja tani, Shtetet kanë për obligim që tu mundësojë shtetasve të tyre që jetojnë jashtë vendit të drejtën e tyre për të votuar."* Më tutje, GJEDNJ theksoi se: *"Përkitazi me mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte nga shtetet të cilat veçse e lejojnë votimin nga jashtë – aplikohen qasje dhe mënyra nga më të ndryshmet"*.

164. Si rrjedhojë, GJEDNJ arriti në përfundimin se në këtë rast *"nuk mund të thuhej se thelbi i të drejtës së votës i garantuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së ishte shkelur. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të këtij neni."* (Shih *Sitaropoulos dhe Giakoumopoulos kundër Greqisë,* cituar më lartë.)

165. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se, deri në këto momente, në nivel të Këshillit të Evropës nuk ekziston një obligim detyrues sipas të cilit shtetet janë të obliguara që patjetër të garantojnë të drejtën e votimin nga jashtë. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në interpretim të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së gjithashtu nuk parasheh ndonjë obligim për shtetet që patjetër të mundësojnë votimin nga jashtë. Madje, edhe në rastin kur Greqia nuk e ka mundësuar këtë lloj votimi për parashtruesit në rastin e lartcituar, GJEDNJ nuk ka konsideruar se është shkelë thelbi i të drejtës së votës.

166. Nga dokumentet e Komisionit të Venecias dhe trupave të tjerë të Këshillit të Evropës, përfundimisht rezulton që trashëgimia e deritashme zgjedhore evropiane nuk kërkon domosdoshmërisht që një e drejtë e tillë të sigurohet nga shtetet. Megjithatë, shtetet inkurajohen që të krijojnë mekanizma që ofrojnë mundësi të votimit nga jashtë. Kur është fjala specifikisht për votimin me postë theksohet vazhdimisht fakti që shtetet që e lejojnë atë formë votimi duhet të sigurohen që *"shërbimi postar të jetë i besueshëm dhe i sigurtë"* ashtu që integriteti i votës të ruhet në çdo rrethanë. Ndërkaq, përkitazi me mënyrën e ushtrimit të të drejtës për votim nga jashtë për shtetet që e lejojnë këtë formë votimi, GJEDNJ vetëm ka vënë në pah se "*aplikohen qasje dhe mënyra nga më të ndryshmet"* – pa theksuar se neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së parasheh ndonjë obligim për shtetet përkitazi me mënyrën e organizimit apo afatet që mund të vendosen në legjislacionin e shteteve përkatëse.

167. Në këtë aspekt, Gjyata thekson se në rastet kur e drejta e votës nga jashtë, përmes postës, garantohet me legjislacionin në fuqi, atëherë shtetet duhet të sigurohen që personave që e ushtrojnë këtë të drejtë përmes votimit me postë, tu respektohen garancionet e mishëruara në nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

168. Gjykata sqaron se rasti KI207/19 nuk ka të bëjë me të drejtën e votës nga jashtë si koncept dhe si e drejtë në vetvete (siç kishte të bënte rasti i lartelaboruar i GJEDNJ-së) – meqë një e drejtë e tillë veçse është e garantuar me ligjin e aplikueshëm zgjedhor në Republikën e Kosovës. Kjo e fundit hyn në grupin e shteteve që e garantojnë këtë të drejtë, siç edhe ceket në vet Aktgjykimin e GJEDNJ-së cituar më lart ku përmendet edhe Kosova (shih *Sitaropoulos dhe Giakoumopoulos kundër Greqisë,* paragrafi 152). Rasti KI207/19 ka të bëjë me kushtet ligjore që e rregullojnë aspektin procedural dhe praktik të ushtrimit të së drejtës së votës përmes votimit me postë nga jashtë, dhe më specfikisht me afatin brenda të cilit votat nga jashtë duhet të arrijnë në KQZ, dhe nëse një afat i tillë cenon të drejat që garanton neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

169. Rikujtojmë që ligji i aplikueshëm në Republikën e Kosovës, respektivisht neni 96.2 i LZP-së parasheh që: *"Vota përmes Votimit Jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja para ditës së zgjedhjeve, sikurse përcaktohet me anë të rregullave të KQZ-së."* Më tutje, neni 4.4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 parasheh që: *"Votat jashtë Kosovës duhet të pranohen nga KQZ-ja 24 orë para ditës së zgjedhjeve"*.

170. Gjykata Supreme, në të dy vendimet e kontestuara, ka arritur në përfundimin se afati ligjor për arritjen e votave nga jashtë në KQZ - njëzet e katër (24) orë para ditës së zgjedhjeve –në rastin konkret është *"në kolizion"* me nenin 3 të Protkollit nr. 1 të KEDNJ-së, si normë e rangut kushtetues, andaj në këtë rast ka shmangur aplikimin e atij afati duke u bazuar në nenin 3 të Protkollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Zbatimi i parimeve të larcekura në rrethanat e rastit konkret

171. Siç u theksua më lart, Gjykata në vijim do të analizojë pajtueshmërinë e vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke marrë për bazë parimet e përgjithshme përkitazi me votimin nga jashtë.

172. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të vendosë nëse Gjykata Supreme ka vepruar në përputhje me autorizimet e saj kushtetuese dhe në përputhje me nenet e larcekura kur ka vendosur që afati ligjor për pranimin e votave nga jashtë, i përcaktuar me nenin 96.2 të LPZ-së dhe nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 është në kolizion me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

173. Për të arritur tek një konstatim i tillë, Gjykata në vijim do të vlerësojë nëse (i) neni 96.2 i LPZ-së në lidhje me nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 është në kolizion me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; dhe, pastaj, Gjykata do të vlerësojë nëse (ii) vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme janë në përputhje me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Nëse neni 96.2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në lidhje me nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 është në kolizion me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

174. Gjykata fillimisht rikujton që Gjykata Supreme kishte shpallur nenin 96.2 të LZP-së në lidhje me nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore nr.

03/2013 si normë të rangut ligjor në kolizion ose kundërshtim me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si normë e rangut kushtetues.

175. Përkitazi me kolizionin e shpallur nga Gjykata Supreme, Gjykata Kushtetuese rikujton qartësimin e GJEDNJ-së se KEDNJ nuk i obligon shtetet që patjetër të garantojnë të drejtën e votës nga jashtë për shtetasit jo-rezident.

176. Megjithatë, përkundër faktit që neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk i obligon shtetet që patjetër të mundësojnë votimin nga jashtë, Republika e Kosovës është ndër shtetet që ka vendosur këtë të drejtë t'ua garantojë shtetasve të saj jo-rezidentë. Në rastet kur shtetet garantojnë një të drejtë të karakterit jo-absolut, ato gjithashtu kanë të drejtë që të përcaktojnë kushtet ligjore për ushtrimin e të drejtës në fjalë.

177. Koncepti i *"kufizimeve të nënkuptuara"* ("implied limitations") sipas nenit 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së ka një rëndësi të madhe për përcaktimin e përshtatshmërisë së qëllimeve të ndjekura me kufizimet e bëra në të drejtat e garantuara me këtë nen. Duke qenë se nuk ekziston një listë specifike e qëllimeve legjitime që mund të arsyetojnë kufizimin e të drejtave të garantuara me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, kjo nënkupton se GJEDNJ *"nuk aplikon testin tradicional të "nevojës"* ("necessity") *ose të "nevojës e shtytëse shoqërore"* ("pressing social need") *që përdoren në nenet 8-11 të KEDNJ-së"* (shih rastin e GJEDNJ-së, *Partia e Bashkuar Demokratike Ruse Yabloko dhe të tjerët kundër Rusisë*, kërkesa nr. 18860/07, Aktgjykim i 8 nëntorit 2016, paragrafët 68 dhe 69 dhe vendimet e tjera të cituara aty).

178. Në rastin e lartcekur, GJEDNJ ka theksuar se në vlerësimin e pajtueshmërisë me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja është fokusuar në dy kritere kryesore: (i) *"nëse ka pasur arbitraritet ose mungesë të proporcionalitetit"*; dhe, (ii) *"nëse kufizimi ka ndikuar në shprehjen e lirë të vullnetit të popullit"*.

179. Ajo çfarë GJEDNJ kërkon të sigurojë është që: (i) kufizimet e paraqitura nuk pakësojnë të drejtat në fjalë deri në pikën që të dëmtojnë thelbin e tyre dhe t'i privojë ato nga efektiviteti i tyre; (ii) kufizimet janë vendosur në ndjekje të një qëllimi legjitim; dhe, (iii) masat e ndërmarra nuk janë joproporcionale. Në veçanti, çdo kusht ose kufizim i vendosur në të drejtat e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së duhet të mos pengojë shprehjen e lirë të njerëzve për zgjedhje të legjislativit. Kjo nënkupton që kufizimet në fjalë *"duhet të reflektojnë, ose të mos shkojnë në kundërshtim me brengën për të*

mirëmbajtur integritetin dhe efektivitetin e një procedure zgjedhore të krijuar me qëllim të identifikimit të vullnetit të popullit përmes votimit universal." (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Partia e Bashkuar Demokratike Ruse Yabloko dhe të tjerët kundër Rusisë,* paragrafi 63.)

180. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që për nivel vendor, përveç KEDNJ-së, rëndësi po aq të madhe kanë dispozitat e Kushtetutës që rregullojnë mënyrën e kufizimit të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton përmbajtjen e nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, bazuar në të cilin mund të kufizohet edhe e drejta e votës, si një nga të drejtat jo absolute të garantuara me Kushtetutë.

181. Testi i këtij neni kërkon që të vlerësohet nëse: (1) kufizimi i të drejtës është i paraparë me ligj; (2) ekziston një qëllim legjitim që synohet të arrihet me atë kufizim; (3) ekziston një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit të të drejtave dhe qëllimit legjitim që synohet të arrihet (shih rastet e Gjykatës: KO157/18, parashtrues *Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 13 marsit 2019; KO54/20, parashtrues *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 31 marsit 2020, paragrafi 197-198; KO61/20, parashtrues *Uran Ismajli dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 1 majit 2020). Përgjatë vlerësimit vijues të këtyre pikave, Gjykata gjithashtu do të ketë parasysh kriteret e lartcekura përmes së cilave GJEDNJ bën vlerësimin e kufizimeve që ndërlidhen me të drejtat e votës.

(1) Nëse kufizimi i të drejtës së votës ishte i paraparë me ligj

182. Përkitazi me atë se a ishte kufizimi i të drejtës për të votuar nga jashtë i "paraparë me ligj", Gjykata rikujton se institucionet e pushtetit publik gëzojnë një margjinë të lirë të vlerësimit të çështjeve të interesit të përgjithshëm dhe të mbulimit të sferave të ndryshme me ligje specifike.

183. Gjykata rikujton që as neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së e as neni 45 i Kushtetutës nuk flasin në mënyrë specifike për të drejtën e votës nga jashtë e as për mënyrën se si do të mund të kufizohej ajo e drejtë nëse garantohet. Ajo që është e qartë është se këto dy nene, nuk e ndalojnë garantimin e votës nga jashtë, si mënyrë e ushtrimin të aspektit aktiv të së drejtës së votës. Rregullimet e kushteve ligjore të së drejtës për votim nga jashtë, nëse ajo garantohet me ligj, Kushtetuta i ka lënë që të bëhen me norma të rangut ligjor.

184. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që shteti i Kosovës, në zbatim të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 45 të Kushtetutës, përmes LZP-së, ka garantuar të drejtën e votës nga jashtë dhe përmes së njëjtit ligj ka përcaktuar kriteret, kushtet dhe afatet për ushtrimin e kësaj të drejte. Për sa i takon specifikisht çështjes së afatit ligjor brenda të cilit duhet të arrijnë votat nga jashtë, LZP ka përcaktuar që vota nga jashtë *"duhet të pranohet nga KQZ-ja 24 orë para ditës së zgjedhjeve"*.

185. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se obligimi i karakterit kufizues që të gjitha votat nga jashtë të arrijnë njëzet e katër (24) orë para datës së zgjedhjeve përbën kufizim të së drejtës së votës të paraparë me ligj.

(2) Nëse ekziston një qëllim legjitim që synohet të arrihet me kufizimin në fjalë

186. Përkitazi me atë se a kishte një "qëllim legjitim" që synohej të arrihej përmes kufizimit të të drejtës për votim nga jashtë, Gjykata rikujton përmbajtjen e neneve relevante të LZP-së, ku është rregulluar kjo mënyrë e veçantë e ushtrimit të së drejtës së votës dhe ku mund të identifikohen qëllimet e synuara për kufizimin e saj.

187. Konkretisht, dy nga trembëdhjetë qëllimet kryesore që LZP kanë për synim të rregullojë: *"c) njohj*[a] *dhe mbrojtj*[a] *e të drejtës për të votuar dhe kriteret e pranueshmërisë së votës";* dhe *"m) procedurat e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve"* (shih neni 1 i LZP). E drejta për të votuar nga jashtë i garantohet edhe personit që *"b) banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës"* (shih neni 5.1 b) i LZP). Votimi jashtë Kosovës garantohet për *"Votuesi[n] me të drejtë vote i cili përkohësisht banon jashtë, ose është zhvendosur nga Kosova ka të drejtë të votojë në zgjedhje sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara me këtë ligj"* (shih neni 6.2 i LZP).

188. Përveç këtyre dispozitave të lartcekura, LZP i ka kushtuar një kapitull të veçantë *"Votimi*[t] *nga Jashtë"* ku përcaktohen dispozitat e përgjithshme, aplikimi për të votuar nga jashtë, konfirmimi dhe procesi i ankesave (shih Kapitulli XIV i LZP). Në paragrafin 1 të nenit 96 thuhet se: *"Votuesi me të drejtë vote i cili përkohësisht mungon në Kosovë mund të votojë për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës nëse ai ose ajo ka aplikuar suksesshëm për Votim Jashtë Kosovës dhe ka votuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e KQZ-së."* Më tutje, paragrafi 2 i nenit 96 (i cili është shpallur nga Gjykata Supreme si normë në kolizion me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të

KEDNJ), përcakton se vota përmes votimit nga jashtë duhet të pranohet nga KZQ *"para ditës së zgjedhjeve"* (shih neni 96 i LZP) që si dispozitë konkretizohet më tutje me nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 ku theksohet që vota duhet të arrijë 24 orë para ditës së zgjedhjeve.

189. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se *ratio legis* e nenit 96.2 të LZP në lidhje me nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 është garantimi i një procesi efikas dhe efektiv të numërimit të votave dhe përmbylljes së rezultateve zgjedhore brenda një kohe të arsyeshme kohore, duke përfshirë votat nga jashtë ashtu që të njëjtat të konsideron si të ligjshme për tu numëruar dhe për tu përfshirë në rezultatin përfundimtar zgjedhor. Ky qëllim kufizon të drejtën e votës nga jashtë me afat.

190. Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, kufizimet e të drejtës së votës janë në pajtim me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nëse të njëjtat janë në përputhje me: (i) parimin e sundimit të ligjit; dhe (ii) objektivat e përgjithshme të KEDNJ-së.

191. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se as neni 45 i Kushtetutës nuk citon specifikisht qëllime legjitime mbi të cilat mund të kufizohet e drejta e votës. Andaj, kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet nëse është në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës si dhe nëse kufizimi në fjalë respekton parimin e sundimit të ligjit dhe objektivat e përgjithshme të KEDNJ-së dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

192. Vendosja e kushteve ligjore dhe afateve respektive për ushtrim të së drejtës së votës janë të domosdoshme për të krijuar një sistem efektiv dhe efikas zgjedhjesh të nivelit qendror dhe lokal. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se qëllimet e shprehura përmes LPZ-së që të rregullohen procedurat e votimit nga jashtë me afate respektive në dritën e garantimit të një procesi zgjedhor ku votat arrijnë brenda një afati të caktuar dhe procesi zgjedhor i numërimit nis dhe përfundon brenda një afati të caktuar – janë kufizime ligjore të domosdoshme, të nevojshme dhe legjitime.

193. Kuvendi si ligjvënës ka konsideruar se ky është një afat i duhur, i nevojshëm dhe i arsyeshëm. Kuvendi është në pozicionin më të mirë për të vendosur për një aspekt të tillë rregullativ dhe për të analizuar për nga aspekti i politikave publike cilat afate sigurojnë një proces zgjedhor efikas dhe efektiv që mundëson shprehjen e lirë të vullnetit të popullit. Është Kuvendi ai që përmes ligjeve ka autoritetin të pëcaktojë afatet që konsideron se e ruajnë integritetin e votës dhe të të

gjithë procesit zgjedhor. Në rast se është e nevojshme të ndryshohet norma ligjore që përcakton afatin, atëherë mund të shfrytëzohen mekanizmat ekzistues të ligjbërjes për të shtyer para një proces të ndryshimit eventual. Megjithatë, edhe pse Kuvendi si organ legjislativ është ai që vendosë për kornizën ligjore, duke përfshirë afatet për votim nga jashtë, të gjitha çështjet e rregulluara në nivel ligji duhet të jenë gjithnjë në përputhje me Kushtetutën.

194. Andaj, Gjykata thekson se në rrethana të rastit konkret nuk ka para vetës asnjë argument që do të dëshmonte se kushtëzimi i vlefshmërisë së votës nga jashtë me afat specifik brenda të cilit e njejta duhet të arrij në KQZ – të jetë një kufizim që nuk ndjek një qëllim legjitim.

195. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rrethana të rastit konkret kufizimi i të drejtës së votës me një afat specifik brenda të cilit votat duhet të arrijnë në KQZ manifeston një qëllim legjitim drejt synimit për të garantuar një proces efikas dhe efektiv të numërimit të votave dhe përmbylljes së rezultateve zgjedhore brenda një kohe të arsyeshme kohore. Kufizimi në fjalë është legjitim si dhe është në pajtim me parimin e sundimit të ligjit dhe me objektivat e përgjithshme të KEDNJ-së dhe të Kushtetutës.

(3) Nëse ekziston një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit të së drejtës së votës dhe qëllimit legjitim që synohet të arrihet me kufizimin në fjalë

196. Përkitazi me atë se a kishte një marrëdhënie "proporcionaliteti" ndërmjet kufizimit të së drejtës për të votuar nga jashtë dhe qëllimit legjitim që synohej të arrihej përmes këtij kufizimi, Gjykata do të vlerësojë nëse masa në fjalë ishte proporcionale në raport me qëllimin legjitim të ndjekur nga kufizimi përkatës.

197. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në thelb, qëllimi legjitim i normës së LZP që përcaktonte afatin e arritjes së votave nga jashtë 24 orë para ditës së zgjedhjeve ishte përmbyllja e procesit zgjedhor dhe shpallja e rezultateve zgjedhore brenda një afati të arsyeshëm. Pyetja që ngelet ka të bëjë me atë se a paraqet afati i përcaktuar për të arritur këtë synim një masë ndërhyrëse proporcionale apo jo.

198. Në rastet kur GJEDNJ vlerëson se a ishte një ndërhyrje në të drejtën e votës proporcionale apo jo, ajo fillimisht thekson faktin që *"ekzistojnë mënyra të ndryshme të organizimit dhe të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor"*. Këto ndryshime të thella, *inter alia*, vërehen *"në aspektin e zhvillimit historik, diversitetit kulturor dhe mendimit*

politik në Evropë dhe si të tilla i shërbejnë çdo Shteti Kontraktues që t'i përmbrendësoj në vizionin e vet demokratik". Kjo sipas GJEDNJ-së nënkupton që proporcionaliteti i një sistemi zgjedhor dhe i çdo kufizimi në të drejtat e votës duhet të analizohet në dritën e rrethanave të një shteti të caktuar (shih *Shindler kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 19840/09, Aktgjykim i 7 majit 2013, paragrafi 102 dhe referencat e cituara aty).

199. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se sistemi zgjedhor i Republikës së Kosovës lejon votimin nga jashtë dhe e kufizon ushtrimin e saj, ndër tjerash, me afate përkatëse. Qëllimi i ligjvënësit është që të caktojë një afat ligjor brenda të cilit duhet të përmbyllet procesi i pranimit të pakove me fletëvotime nga jashtë, pasi në të kundërtën kjo do të mund të shkonte në pafundësi të përmbylljes së procesit zgjedhor. Siç u shpjegua edhe në pjesën e parimeve të përgjithshme, të gjitha shtetet që e garantojnë këtë të drejtë, përcaktojnë procedurat dhe afatet respektive për ushtrimin e saj.

200. Gjykata rikujton që për shtetet që e garantojnë të drejtën e votës nga jashtë përmes postës, GJEDNJ vetëm ka theksuar se "*aplikohen qasje dhe mënyra nga më të ndryshmet"* – pa e theksuar se neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së parasheh ndonjë obligim për shtetet përkitazi me mënyrën e organizimit apo afatet që mund të vendosen në legjislacionin e shteteve përkatëse. Ato shtete që e garantojnë këtë të drejtë duhet të sigurohen që *"shërbimi postar të jetë i besueshëm dhe i sigurtë"* ashtu që të ruhet integriteti i votës. Gjithashtu, GJEDNJ ka potencuar se në shumicën e vendeve që e lejojnë votimin nga jashtë, ekziston një procedurë paraprake administrative përmes së cilës personat e interesuar duhet të paraqiten dhe të regjistrohen – bazuar në afatet ligjore që përcaktohen nga shtetet që lejojnë këtë formë të votimit (shih *Sitaropoulos dhe Giakoumopoulos kundër Greqisë*, cituar më lart, paragrafët 39-45).

201. Në aplikim të kësaj praktike gjyqësore, Gjykata vlerëson se norma ligjore në fjalë nuk reflekton ndonjë arbitraritet ose mungësë proporcionaliteti dhe kufizimi i të drejtës së votës me afat, brenda të cilit e njejta duhet të pranohet në organet kompetente, nuk pamundëson shprehjen e lirë të vullnetit të popullit. Afati në fjalë nuk shkelë thelbin e së drejtës së votës dhe si i tillë nuk pengon e as nuk ka penguar votuesit jo-rezidentë, në rrethana të rastit konkret, që të realizojnë të drejtën e tyre brenda afateve ligjore dhe që votat e tyre të numërohen e më pas përfshihen në rezultatin përfundimtar.

202. Është më se e qartë se ekziston një nevojë e domosdoshme që procesi i pranimit të votave nga jashtë të rregullohet me afate specifike ashtu

që të mos lejohet krijimi i një rrethi vicioz të pranimit të vazhdueshëm të votave dhe numërimit të vazhdueshëm të votave në momentet kurdo që ato arrijnë. Kjo do të shkaktonte pamundësinë e përmbylljes dhe të shpalljes së rezultateve përfundimtare. Andaj, afati specifik i përcaktuar me LZP përbën një masë proporcionale që kontribuon drejt garantimit të integritetit të procesit zgjedhor dhe përfundimit të tij në mënyrë efektive.

203. Gjykata përfundimisht vlerëson se masa e ndërmarrë është proporcionale drejt qëllimit që është synuar dhe nuk pakëson të drejtën e votës deri në pikën që ta dëmtojë thelbin e saj. Kufizimi në fjalë është proporcional dhe i nevojshëm për të mirëmbajtur integritetin dhe efektivitetin e procedurës zgjedhore të krijuar me qëllim të identifikimit të vullnetit të popullit përmes votimit universal.

204. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundimin se afati ligjor i përcaktuar nga Kuvendi për arritjen e votave nga jashtë përmes nenit 96.2 të LZP-së në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 ishte një kufizim i të drejtës së votës i cili ishte në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës ngase i njëjti: (1) ishte i paraparë me ligj; (2) kishte një qëllim legjitim që synohej të arrihej me atë kufizim; dhe (3) kishte një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit të kësaj të drejte dhe qëllimit legjitim që synohej të arrihej me atë kufizim. Në rrethanat e rastit konkret, kufizimi me afat ligjor i të drejtës së votës (si e drejtë relative dhe jo absolute) nuk ka qenë arbitrar dhe nuk ka ndikuar në pamundësim të shprehjes së lirë të vullnetit të popullit përkitazi me përfaqësuesit e vet në Kuvend.

Nëse vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme janë në përputhje me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nëse arsyetimi i Gjykatës Supreme është i mjaftueshëm dhe adekuat

205. Gjykata sërish rikujton që Gjykata Supreme kishte shpallur nenin 96.2 të LZP-së në lidhje me nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 si normë të rangut ligjor në kolizion ose kundërshtim me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si normë e rangut kushtetues.

206. Në këtë drejtim, Gjykata paraprakisht sqaron se garancitë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së mbi bazën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të kësaj Gjykate - nuk janë të aplikueshme në konteste zgjedhore (shih ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Pierre-Bloch kundër Francës*, Aktgjykim i 21 tetorit 1997, paragrafi 50; shih gjithashtu rastin KI48/18, parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, cituar më lart, paragrafi

185). Çështjet që përfshijnë konteste zgjedhore bien jashtë fushëveprimit të nenit 6 të KEDNJ-së përderisa ato kanë të bëjë me "të drejta politike" dhe rrjedhimisht nuk e përmbushin kriterin e të qenurit "të drejta dhe obligime civile" sipas paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, *Paunović dhe Milivojević kundër Serbisë*, Aktgjykim i 24 majit 2016, paragrafi 75).

207. Kjo nuk nënkupton që vendimet që ndërlidhen me konteste zgjedhore nuk duhet të jenë të arsyetuara. Megjithatë, arsyetimi i një vendimi gjyqësor në konteste zgjedhore duhet të vihet në kontekstin e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 45 të Kushtetutës. Sipas GJEDNJ-së, procedura e shqyrtimit të kontesteve zgjedhore duhet të përfshijë patjetër një *"vendim mjaftueshëm të arsyetuar"* në mënyrë që *"të parandalohet abuzimi i pushtetit nga autoriteti relevant vendimmarrës"* (shih rastin e GJEDNJ, *Kerimova kundër Azerbajxhanit*, nr. 20799/06, Aktgjykim i 30 shtatorit 2010, paragrafët 44-45; shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI48/18, parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 185 dhe rastet e raportet tjera të cituara aty).

208. Andaj, në përputhje me praktikën e lartcekur gjyqësore, Gjykata do të vlerësojë kushtetutshmërinë e dy vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme në dritën e garancive të nenit 45 të Kushtetutës dhe nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

209. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton faktin që të dy vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme janë pothuajse identike, si për nga arsyetimi ashtu edhe për nga përfundimet e arritura. Rrjedhimisht, analiza e Gjykatës për të dyja vendimet do të jetë e përbashkët.

210. Rrethanat e rastit konkret tregojnë se në këtë rast zgjedhor kemi të bëjmë me të drejtën për tu zgjedhur, respektivisht aspektin pasiv të së drejtës së votës i cili synohet të mbrohet nga parashtruesi i kësaj kërkese, Koalicioni "NISMA-AKR-PD" (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI01/18, *Gani Dreshaj dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës*, cituar më lart, pjesën ku shpjegohet gjerësisht koncepti i aspektit pasiv të së drejtës së votës, paragrafët 99-122).

211. Gjykata rikujton që Gjykata Supreme kishte shfuqizuar dy vendime të PZAP-së që nuk lejonin numërimin e dy pakove me vota që kishin arritur jashtë afatit të paraparë ligjor, duke e zëvendësuar atë qëndrim me qëndrimin se ato vota, pavarësisht se ishin pranuar jashtë afatit, duhet të numëroheshin.

212. Për sa i takon çështjes së afatit ligjor brenda të cilit duhet të arrijnë votat nga jashtë, si çështje kryesore në këtë rast, Gjykata rikujton që as për Gjykatën Supreme e as për KQZ-në apo PZAP-në nuk kishte ndonjë dilemë rreth qartësisë së normës ligjore dhe faktit që ajo normë ligjore parashihte obligimin për pranim të votave nga KQZ një ditë para ditës së zgjedhjeve.

213. Rrjedhimisht, në të dy vendimet e kontestuara Gjykata Supreme pranoi se sipas legjislacionit zgjedhor në fuqi, të gjitha votat që kërkohej të numëroheshin do duhej të arrinin në KQZ të paktën një ditë para ditës së zgjedhjeve të 6 tetorit 2019. Megjithatë, ndryshe nga KQZ dhe PZAP të cilat insistonin në zbatimin e normës ligjore në fjalë, Gjykata Supreme kishte konsideruar se ajo normë ligjore është në *"kolizion"* me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Si rrjedhojë, Gjykata Supreme kishte vendosur të mos aplikojë normën ligjore të LZP-së por të zbatojë direkt nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ – duke lejuar dhe urdhëruar kështu KQZ-në që të numërojë votat që kishin arritur pas afatit të përcaktuar me ligj dhe t'i përfshijë ato në rezultatin përfundimar.

214. Vendimarrjen e saj në dy vendimet e kontestuara Gjykata Supreme e kishte arsyetuar fillimisht duke u thirrur në nenet 31.1, 32, 54 të Kushtetutës dhe nenin 3 të Protkollit nr. 1 të KEDNJ-së. Nga arsyetimi në fjalë, vërehet se Gjykata Supreme vetëm kishte cituar përmbajtjen e këtyre neneve pa shpjeguar asgjë tjetër rreth aplikueshmërisë dhe lidhshmërisë së tyre me rrethanat e rastit dhe me përfundimin e arritur për kolizion normash.

215. Më konkretisht, Gjykata vëren se Gjykata Supreme nuk kishte marrë parasysh faktin që neni 31 i Kushetutës në parim nuk aplikohet në konteste zgjedhore përkundër faktit që në një rast tjetër zgjedhor në vitin 2019 Gjykata Kushtetuese veçse e kishte theksuar këtë qëndrim të GJEDNJ-së (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI48/18, *parashtrues Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës,* cituar më lart, paragrafin 185). Ndërkaq, për sa i takon neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata Supreme nuk kishte dhënë asnjë argument se si ishte shkelur e drejta për mjete juridike apo se si ishte cenuar mbrojtja gjyqësore e të drejtave e ndonjërës palë.

216. Gjykata Supreme më tutje kishte cituar nenin 22 të Kushtetutës dhe në bazë të përmbajtjes së këtij neni kishte konstatuar se: "*konkludimi juridik i PZAP-së se apeli i paraqitur nga subjekti politik [...] (LVV) është i pabazuar, bie ndesh me Protokollin nr. 1-Neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*" Sipas Gjykatës Supreme konkludimi i PZAP-së se fletëvotimet janë të pasafatshme "*është në*

kundërshtim me nenin e cekur i cili garanton të drejtën për të votuar dhe të drejtën për tu zgjedhur" ngase "*Parimi i votimit universal është shumë i fortë dhe shtetit i kërkohet në mënyrë shumë strikte të justifikojë humbjen e votës nga individë ose kategori të caktuara personash".*

217. Në bazë të arsyetimit të lartcekur Gjykata Supreme kishte arritur në përfundimin se "*neni 96 par. 2 i Ligjit për Zgjedhjet të Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe neni 4 par. 4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 janë në kolizion me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili përfshin të drejtën për zgjedhje të lira, dhe në rastin konkret votuesit pa fajin e tyre ishin privuar nga mundësia për të shprehur mendimin e tyre në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës"* dhe se, për rrjedhojë, *"votuesve u është mohuar vetë thelbi i së drejtës për të votuar, siç garantohej nga neni 3 i Protokolli nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

218. Krejt në fund, Gjykatës Supreme theksoi se "*arritja me vonesë e [...] fletëvotimeve nuk tangon rregullsinë dhe ligjshmërinë e tyre, meqë, në njërën anë, këta votues kanë votuar në kohën e duhur dhe pa fajin e tyre fletëvotimet e tyre nuk kanë arritur në KQZ para ditës së zgjedhjeve, dhe në anën tjetër, se procesi i numërimit të fletëvotimeve ka qenë në vazhdim e sipër dhe kjo nuk kishte për të ndikuar në rregullsinë e procesit të numërimit të fletëvotimeve."* Përkundrazi, sipas Gjykatës Supreme "*mos numërimi i këtyre fletëvotimeve, me bazë ligjore dhe kushtetuese, e bën të kontestueshëm gjithë procesin e numërimit të fletëvotimeve në këto zgjedhje parlamentare".*

219. Gjykata rikujton që veçanërisht në rastet kur ndryshohet një vendim i një shkalle më të ulët, gjykata që ndryshon vendimmarrjen paraprake e ka për obligim që të ofrojë një "vendim mjaftueshëm të arsyetuar" ashtu që vendimmarrja e saj të mos shëndrrohet në vendimarrje "arbitrare" por të jetë e bazuar në argumente bindëse dhe arsyetime përkatëse që mbështesin përfundimet e arritura.

220. Gjykata vlerëson se arsyetimi i Gjykatës Supreme dhe përfundimet e arritura bazuar në atë arsyetim nuk plotësojnë kriteret e një vendimi mjaftueshëm të arsyetuar. Në rrethana të rastit konkret, Gjykata Supreme ka dështuar të arsyetojë përse qëndrimet e PZAP-së kanë qenë të gabuara dhe në papajtueshmëri me LZP-në, Kushtetutën dhe KEDNJ-në. Gjykata Supreme gjithashtu ka dështuar të arsyetojë specifikisht se përse afati ligjor i përcaktuar me LZP është në kundërshtim me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

221. Arsyetimi nuk mund të kaloj pragun e mjaftueshmërisë e as të mos cilësohet si jo-arbitrar ngase Gjykata Supreme nuk ka elaboruar asnjë nga çështjet vijuese që ishin relevante dhe të nevojshme për tu qartësuar në rrethanat e rastit konkret, si për shembull: (i) çfarë nënkupton "parimi i votimit universal" në të cilin është thirrur, si ndërlidhet ai parim me të drejtën e votës nga jashtë dhe si është shkelur i njëjti në rrethanat e rastit konkret; (ii) cilat janë obligimet që neni 3 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së vendosë mbi shtetet përkitazi me votimin nga jashtë; (iii) çfarë është saktësisht ajo që e bën afatin e përcaktuar në nenin 96.2 të LZP në lidhje me nenin 4.4. të Rregulles Zgjedhore 03/2013 të jetë normë në kolizion me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

222. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka përmendur shkarazi disa nga koncepte të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së – mirëpo nuk e ka elaboruar asnjërin prej tyre në dritën e rrethanave të rastit konkret. Gjykata Supreme nuk e ka mbështetur vendimmarrjen e saj me ndonjë argument të vlefshëm juridik ose ligjor, dokument ndërkombëtar, praktikë gjyqësore të GJEDNJ-së, opinion/raport të Komisionit të Venecias apo ndonjë arsyetim tjetër bindës që do të arsyetonte dhe mbështeste përfundimet e saj për kolizion të mundshëm.

223. Së pari, për sa i takon shkeljes së parimit të votimit universal, Gjykata Supreme kishte theksuar se parimi i votimit universal *"është shumë i fortë"* dhe shtetit i kërkohet në mënyrë shumë strikte të justifikojë humbjen e votës nga individë ose kategori të caktuara personash. Gjykata rikujton se sipas Kodit të Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore të përgatitur nga Komisioni i Venecias: *"Votimi universal konsiston në të drejtën zgjedhore aktive (e drejta për të votuar) si dhe pasive (e drejta për t'u zgjedhur). E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur mund t'i nënshtrohet një numër kushtesh [...]. Kushtet më të zakonshme janë ato që kanë të bëjnë me moshën dhe shtetesinë"* (shih pikën 1. Votimi universal, 1.1. Rregulli dhe Përjashtimet, faqe 14). Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se ky parim nuk ishte shkelur dhe se nuk kishte humbje të votës e as mohim të së drejtës së votës por thjesht aplikim korrekt të afateve ligjore të LZP-së. Çështja konkrete nuk kishte të bënte asgjë me moshën ose shtetësinë e votuesve por vetëm me afatin brenda të cilit votat duhet të arrijnë në Kosovë. Andaj, Gjykata konsideron se arsyetimi i Gjykatës Supreme përkitazi me këtë parim është i mangët dhe ka dërguar në interpretim të pasaktë të këtij parimi.

224. Së dyti, për sa i takon obligimeve që neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së vendosë mbi shtetet përkitazi me votimin nga jashtë, Gjykata

Supreme kishte theksuar se ky nen *"përfshin të drejtën për zgjedhje të lira"* dhe se votuesve iu është mohuar *"thelbi"* i së drejtës së votës. Përderisa Gjykata pajtohet me konstatimin se ky nen i KEDNJ-së përfshin të drejtën për zgjedhje të lira, Gjykata nuk pajtohet me konstatimin se në rastin konkret ishte shkelur thelbi i së drejtës së votës. Kjo për faktin se një konstatim i tillë është haptazi në kundërshtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ku ishte theksuar se mos-mundësimi i shtetasve grek jo-rezident që të mos kenë fare mundësi të votojnë nga jashtë nuk kishte shkelur thelbin e së drejtës së votës. Për rrjedhojë, mundësimi i votimit nga jashtë por kushtëzimi i kësaj të drejte me caktim të afatit brenda të cilit votat duhet të arrijnë paraqet ndëhyrje shumë më e vogël në të drejtën e votës që kurrsesi nuk mund të konsiderohet se ka mohuar "thelbin" e së drejtës së votës në rastin konkret (shih *Sitaropoulos dhe Giakoumopoulos kundër Greqisë*, cituar më lart). Andaj, Gjykata konsideron se arsyetimi i Gjykatës Supreme përkitazi me thelbin e së drejtës së votes është i mangët dhe ka dërguar në interpretim të pasaktë të këtij koncepti.

225. Së treti, për sa i takon asaj se çfarë është saktësisht ajo që e bën afatin e përcaktuar në nenin 96.2 të LZP në lidhje me nenin 4.4. të Rregulles Zgjedhore 03/2013 të jetë normë në kolizion me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata Supreme kishte arsyetuar se këto norma ligjore *"janë në kolizion"* ngase *"votuesit ishin privuar nga mundësia për të shprehur mendimin e tyre"* në lidhje me zgjedhjen e deputetëve të Kuvendit. Kjo, rrjedhimisht, sipas Gjykatës Supreme iu kishte mohuar votuesve thelbin e së drejtës së votës që garantohet me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

226. Për sa i takon konstatimit të gabuar të Gjykatës Supreme se thelbi i votës është mohuar, Gjykata thirret në arsyetimin e saj më lart ku veçse u qartësua kjo çështje bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Ndërkaq, përkitazi me faktin se votuesit ishin privuar nga mundësia për të shprehur mendimin e tyre përkitazi me përfaqësuesit e tyre në Kuvend, Gjykata gjithashtu konsideron se edhe ky konstatim i Gjykatës Supreme është i pabazuar në fakte dhe në kundërshtim me interpretimin e KEDNJ-së sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

227. Në rastin më klasik, GJEDNJ konsideron se votuesve iu mohohet mundësia për të shprehur mendimin e tyre drejt zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre kur ata fare nuk kanë asnjë mundësi që të shprehen dhe të votojnë. Për shembull, në rastin *Aziz kundër Qipros* (shih kërkesa nr. 69949/01, Aktgjykim i 22 qershorit 2004, paragrafët 26-30), GJEDNJ kishte gjetur se parashtruesi që ishte anëtar i komunitetit Turko-Qipriot që jetonte në zonën e e Qipros të kontrolluar nga Qeveria e Qipros, *"ishte tërësisht i privuar nga*

mundësia për të shprehur mendimin e tij në zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit të vendit që ai ishte shtetas dhe në të cilin jetonte." Si rrjedhojë, për shkak të pamundësisë absolute të ushtrimit të së drejtës së votës, GJEDNJ kishte gjetur shkelje të "thelbit" të së drejtës së votës të garantuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Madje, në këtë rast, GJEDNJ kishte urdhëruar Qeverinë e Qipros që të ndërmarrë një reformë përmes së cilës do të zbatonte masat e duhura dhe të nevojshme për të siguruar të drejtën e votës për personat që fare nuk mund ta ushtronin atë të drejtë (shih *Aziz kundër Qipros,* cituar më lart, paragrafi 43).

228. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së nuk ka asnjë rast të vetëm ku konstatohet shkelje e thelbit të së drejtës së votës sipas arsyetimit dhe interpretimit që Gjykata Supreme i ka bërë KEDNJ-së. E as praktika ekzistuese për të drejtën e votës nuk dërgon asesi në përfundimin se kushtëzimi i të drejtës së votës nga jashtë me afat mund të konsiderohet si shkelje e thelbit të së drejtës së votës. Andaj, edhe në këtë aspekt, arsyetimi i Gjykatës Supreme është i mangët, i pasaktë dhe arbitrar për arsye se thirret në dispozita të KEDNJ-së si mënyrë për të mos aplikuar një normë ligjore pa dhënë mbështetje të duhura për përfundimet e arritura.

229. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu merr parasysh vendimet e PZAP-së, si instancë e parë në konteste zgjedhore, të cilat Gjykata Supreme i kishte rrëzuar pa ndonjë arsyetim bindës. Siç u tha dhe më lart, në rastet kur instanca e dytë për konteste zgjedhore rrëzon vendimmarrjen e organit të shkallës së parë dhe arsyetimin e saj e zëvendëson me arsyetim të vetin – lind nevoja e një arsyetimi të qartë dhe të mjaftueshëm ligjor se përse është arritur tek një përfundim krejtësisht i kundërt. Vetëm një arsyetim i tillë i mjaftueshëm mundëson që *"të parandalohet abuzimi i pushtetit nga autoriteti relevant vendimmarrës"* (shih rastet e cituara më lart, *Kerimova kundër Azerbajxhanit*, paragrafët 44-45; KI48/18, parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, paragrafi 185).

230. Në thelb, Gjykata rikujton se PZAP konsideronte se neni 96.2 i LZP-së dhe neni 4.4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 nuk e mohojnë thelbin e të drejtës së votës ngase kjo e drejtë kushtetuese mund të shfrytëzohet nga votuesit nga jashtë, por që normat ligjore në fjalë vetëm kanë "*përcaktuar rregullat se si mund të shfrytëzohet kjo e drejtë, [...] çka do të thotë se të njëjtat* [votat nga jashtë] *duhet të arrijnë në KQZ, në afatin prej 24 orëve, para ditës së zgjedhjeve."* Sipas PZAP-së: *"Si votuesit brenda Kosovës, që kanë afat ligjorë të votojnë në ditën e votimit kur hapen Qendrat e Votimit [...] siç kanë votuar në këto zgjedhje me datë 06.10.2019, nga ora 07:00 e deri në*

ora 19:00, që sipas nenit 88 paragrafi 2 të LZP-së, askush nuk mund të hy në Qendrën e Votmit, për të votuar pasi që të mbyllet e njëjta, ashtu edhe për votuesit jashtë Kosovës, është kushti ligjor sipas nenit 96 paragrafi 2 të LZP-së, që pakot me fletëvotime të pranohen nga KQZ-ja, para ditës së zgjedhjeve, që në këtë rast siç edhe u konstatua më lart 4639 pako me fletëvotime të votuesve jashtë Kosovës, janë pranuar nga KQZ-ja, pas afatit të përcaktuar ligjor".

231. Më tutje, PZAP po ashtu arsyetonte se: "*Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës* [LZP] *është në përputhje me Konventë[n] Evropiane për Të Drejtat e Njeriut, respektivisht me protokollet shtesë të saj, më konkretisht me nenin 3.3 të këtij protokolli shtesë, sepse ky kontroll parasheh obligime për shtetet që të sigurojnë mekanizma që iu mundësojnë qytetarëve të ushtrojnë të drejtën e tyre, për të zgjedhur apo për tu zgjedhur, ndërsa neni 96 i LZP-së, nuk e cenon një të drejtë të tillë, por e kufizon afatin e pranimit të fletëvotimit, dhe në këtë rast votuesit jashtë Kosove, kanë pasur afat të mjaftueshëm kohor, për të shfrytëzuar të drejtën e tyre të votës. Këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar mijëra votues të tjerë jashtë vendit, në afatet e përcaktuara me ligj dhe pakot me fletëvotime të të njëjtëve, janë trajtuar të vlefshme".*

232. Gjithashtu, PZAP arsyetonte se: "*Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës është nxjerrë në përputhje me praktikat më të mira të shteteve anëtare të BE-së, ku pjesa dërrmuse e këtyre shteteve e kanë përcaktuar se fletëvotimet duhet ta arrijnë para ditës së zgjedhjeve, ndërsa një pakicë e shteteve e kanë të rregulluara në atë mënyrë që fletëvotimet duhet të arrijnë deri në mbylljen e vendvotimeve në ditën e zgjedhjeve. Krejt kjo i kontribuon garantimit të integritetit të procesit zgjedhor, pasi pranimi i pakove me fletëvotime, pas afatit ligjor të cekur më lartë e minon dhe cenon integritetin e procesit zgjedhor. Në këtë frymë janë edhe rekomandimet e (...) Komisionit të Venecias, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i miratuar datë: 18-19 tetor 2002, të cilat parashohin: "Votimi me postë do të zhvillohej nën një procedurë të veçantë disa ditë para zgjedhjeve".*

233. Si përfundim, PZAP konstatoi se: "*Pranimi dhe trajtimi i pakove me fletëvotime të arritura pas afatit, përveç cenimit të integritetit të procesit zgjedhor e fut KQZ-në, në një rreth vicioz nga i cili është problem të dilet, sepse kjo ia mundëson KQZ-së, që në një afat optimal, të shpall rezultatin zgjedhor dhe nuk afatizon procesin e pranimit të pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë vendit. Kjo i bie në kundërshtim me qëllimin e ligjvënësit, pasi ligjvënësi ka pasur për qëllim që të caktoj afatin ligjor, brenda të cilit duhet të përmbyllet*

procesi i pranimit të pakove me fletëvotime, pasi në të kundërtën kjo do të shkonte në pafundësi të përmbylljes së këtij procesi zgjedhor".

234. Gjykata vëren se këto argumente të PZAP-së, Gjykata Supreme nuk kishte arritur t'i kundërshtojë e as t'i vërtetojë si të të gabuara. Gjykata Supreme nuk kishte arritur të dëshmojë, me asnjë argument bindës, se përse kjo linjë e arsyetimit të PZAP-së duhej zëvendësuar me një linjë krejtësisht tjetër që nuk ishte në përputhje me LZP-në dhe praktikën e deritashme zgjedhore.

235. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme nuk ka ofruar arsyetim të mjaftueshëm ligjor e kushtetues dhe se vendimmarrja e saj në rrethana të rastit konkret ishte arbitrare dhe, për rrjedhojë, në kundërshtim me garancitë e nenit 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Kërkesa për masë të përkohshme

236. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar vendosjen e masës së përkohshme përmes së cilës do të ndalohej certifikimi *"[...] i zgjedhjeve* [të 6 tetorit 2019] *deri në një vendim përfundimtar [...] lidhur me kërkesën kryesore"* të rastit në fjalë.

237. Më 10 dhjetor 2020, Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme dhe gjeti shkeljet e specifikuara në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Kjo vendimmarrje e bën mëtutje të panevojshme shqyrtimin e kërkesës për masë të përkohshme.

Efektet e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese

238. Gjykata në njërën anë ka shpallur të dy Aktgjykimet e Gjykatës Supreme si vendime në papajtueshmëri me nenin 45 të Kushtetutës dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; ndërkaq, në anën tjetër, Gjykata ka shpallur të dy Vendimet e PZAP-së si vendime në pajtim me po ato nene. Për rrjedhojë, Gjykata i ka shfuqizuar vendimet e Gjykatës Supreme dhe i ka lënë në fuqi vendimet e PZAP-it. Së fundmi, sa i përket përputhshmërisë së afatit për pranim të votave nga jashtë të përcaktuar me nenin 96.2 të LZP-së në lidhje me nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore nr.03/2013, Gjykata ka konstatuar se kjo normë ligjore nuk është në kolizion me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

239. Në të gjitha rastet kur konstatohet shkelje e të drejtave dhe lirive të njeriut e cila nuk mund të riparohet tërësisht e as të kthehet në pikën zero kur shkelja nuk ka ekzistuar, shtrohet pyetja e efektit të Aktgjykimit që konstaton shkeljen në fjalë.

240. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që në praktikën e saj gjyqësore të deritanishme nuk është sqaruar më parë çështja e efektit të Aktgjykimit të Gjykatës përkitazi me shkelje të nenit 3 të Protkollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenin 45 të Kushtetutës. Pyetja e efektit të vendimmarrjes është shtruar vetëm për nene të tjera të Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, në këtë drejtim, Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI193/18, parashtrues *Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020, paragrafët 149-151 ku, në mes referencave të tjera, citohet edhe rasti i GJEDNJ-së, *Kingsley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 28 majit 2002, paragrafi 40; KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, Aktgjykim i 8 tetorit 2019, paragrafët 116-120; KI108/18, parashtrues Blerta Morina, Aktvendim për Papranueshmëri i 1 tetorit 2019, paragrafi 196).

241. Në vendimet e lartcekura e të lartcituara, në thelb, Gjykata ka qartësuar se ndonëse ajo *"nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji apo mënyre të kompensimit për rastet kur konstaton shkelje të dispozitave respektive kushtetuese";* një aspekt i tillë nuk nënkupton që individët () *"nuk kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre bazuara në ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës"*.

242. Rastet e lartcekura të Gjykatës dallojnë nga rasti i tanishëm për nga faktet, çështjet e trajtuara, pretendimet e ngritura dhe nenet e trajtuara. Megjithatë, parimet e theksuara vlejnë edhe për rastet kur Gjykata gjen shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës. Ky konfirmim gjendet edhe në nivel të GJEDNJ-së.

243. Në këtë aspekt, Gjykata thirret specifikisht në rastin *Paunović dhe Milivojević kundër Serbisë*, ku GJEDNJ kishte gjetur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së për arsye se *"përfundimi i mandatit të parashtruesit* [deputet i zgjedhur i Kuvendit të Serbisë] *ishte bërë në shkelje të Ligjit për Zgjedhjen e Deputetëve të Kuvendit"*. Revokimin e mandatit të tij të deputetit GJEDNJ e konsideroi si akt që ishte kryer jashtë kornizës së aplikueshme ligjore dhe si i tillë ishte një revokim i paligjshëm (shih rastin e GJEDNJ: *Paunović dhe Milivojević kundër Serbisë,* kërkesa nr. 41683/06, Aktgjykim i 24 majit 2016, paragrafët 61-66).

244. Për sa i takon efekteve të Aktgjykimit, GJEDNJ u deklarua për çështjen e dëmit material dhe jo-material.

245. Sa i përket dëmit material, deputeti parashtrues kishte kërkuar që të kompensohej 4,600.00 EUR për dëmin material të shkaktuar e që korrespondonte me pagën neto dhe shtesat që ai do të mund t'i merrte si deputet (po të mos i revokohej mandatit) përgjatë periudhës nga 16 maj 2006 deri më 14 shkurt 2007. GJEDNJ e pranoi këtë kërkesë të parashtruesit dhe urdhëroi Qeverinë e Serbisë që t'ia paguajë po atë shumë deputetit parashtrues në emër të dëmit material që ai kishte pësuar si pasojë e revokimit të paligjshëm të mandatit të tij (shih rastin *Paunović dhe Milivojević kundër Serbisë,* cituar më lart, paragrafët 81-84).

246. Sa i përket dëmit jo-material, deputeti parashtrues kishte kërkuar që të kompensohej 100,000.00 EUR për dëmin jo-material që ai pretendonte se kishte pësuar si pasojë e mohimit të mundësisë që të ushtrojë mandatin e tij të fituar të deputetit dhe si pasojë e sulmeve dhe padrejtësive që ai dhe familja e tij kishin pësuar. GJEDNJ e refuzoi këtë kërkesë të parashtruesit dhe deklaroi në paragrafin 84 specifikisht se: *"[...] gjetja e shkeljes së nenit 3 të Protokollit nr. 1 përbën dëmshpërblim të drejtë të mjaftueshëm për sa i takon dëmit jo-material dhe rrjedhimisht Gjykata nuk jep dëmshpërblim për këtë aspekt"* (shih rastin *Paunović dhe Milivojević kundër Serbisë,* cituar më lart, paragrafi 84).

247. Në vijim, duke ndjekur parimet e lartcekura, Gjykata do të qartësojë se cilat janë efektet e Aktgjykimit në rastin KI207/19.

248. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht thekson faktin që ky Aktgjykim nuk mund të prodhojë efekt juridik prapaveprues në lidhje me pakot me vota të cilat tashmë janë numëruar nga KQZ me urdhër të Gjykatës Supreme, duke ditur faktin se ato vota tashmë janë përfshirë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 të certifikuar nga KQZ me 27 nëntor 2019. Siç është thënë edhe më lart, deputetët e legjislaturës së VII të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë zgjedhur bazuar në ato rezultate tashmë të konfirmuara. Në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu ka parasysh që bazuar në paragrafin 4 të nenit 103 [Ruajtja e fletëvotimeve dhe transportimi i materialit zgjedhor] KQZ-ja me një vendim, pas certifikimit zyrtar të rezultatit të zgjedhjeve, shkatërron materialet zgjedhore, përfshirë edhe fletëvotimet, në kohën e përshtatshme brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga PZAP.

249. Thënë këtë, kjo nuk do të thotë se ky Aktgjykim është thjesht deklarativ dhe pa asnjë efekt. Janë të paktën tri efekte të menjëhershme të këtij Aktgjykimi; dhe një efekt që ky Aktgjykim mundëson në varësi të vullnetit të parashtruesit të kërkesës.

250. Efekti i parë ka të bëjë me sqarimet interpretative kushtetuese që ky Aktgjykim përçon përkitazi me të drejtat dhe obligimet e gjykatave të rregullta kur ato ballafaqohen me norma ligjore që pretendojnë se janë në kolizion me norma të rangut kushtetues.

251. Efekti i dytë është shfuqizimi i dy vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme si të papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në dhe lënia në fuqi e dy vendimeve të PZAP-së si të pajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-së. Përmes këtij shfuqizimi, respektivisht lënies në fuqi, ky Aktgjykim sqaron për të ardhmen se, përderisa Kuvendi lë në fuqi nenin 96.2 i LZP-së, të gjitha votat që arrijnë në KQZ pas afatit të paraparë ligjor duhet të deklarohen si vota të pavlefshme dhe nuk duhet të përfshihen në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

252. Efekti i tretë është qartësimi se në rrethanat e rastit konkret nuk ka ekzistuar kolizion në mes të normës së rangut ligjor (neni 96.2 i LZP në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2003) dhe asaj të rangut kushtetues (neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së); dhe se, Gjykata Supreme i ka tejkaluar autorizimet e saj kushtetuese duke deklaruar kolizionin në fjalë në mënyrë arbitrare dhe pa arsyetim të mjaftueshëm e adekuat.

253. Efekti i katërt, që ky Aktgjykim mundëson por nuk urdhëron, është fakti që parashtruesit të kërkesës ose palëve të tjera që mund të preken nga ky Aktgjykim, iu lind e drejta për shfrytëzimin e mjeteve të tjera juridike në dispozicion për realizimin e mëtejmë të të drejtave në përputhje me gjetjet e këtij Aktgjykimi.

Përfundime

254. Kërkesa KI207/19 ishte parashtruar nga Koalicioni "NISMA-AKR-PD pas zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të 6 tetorit 2019. Në mënyrë të veçantë, ky rast kishte të bënte me "Votimin nga Jashtë" të realizuar nga shtetasit e Republikës së Kosovës përmes postës nga vende të ndryshme jashtë Kosovës.

255. Çështja kushtetuese që ngërthen kërkesa në fjalë është përputhshmëria me Kushtetutën dhe KEDNJ-në e dy vendimeve të

kontestuara të Gjykatës Supreme, respektivisht Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.20/2019] të 30 tetorit 2019 dhe Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.21/2019] të 5 nëntorit 2019. Konkretisht, nëse vendimmarrja e Gjykatës Supreme se votat nga jashtë vendit duhet të numëroheshin përkundër faktit që ato kishin arritur në KQZ pas afatit prej njëzet e katër (24) orësh para ditës së zgjedhjeve të përcaktuar me nenin 96.2 të LZP-së në lidhje me nenin 4.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013, ishte në kundërshtim: (i) me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (ii) paragrafin 1 të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenin 6 (E drejta për gjykim të drejtë) të KEDNJ; dhe, (iii) nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira), të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

256. Sipas fakteve të rastit, PZAP përmes Vendimeve [A.nr.375-2/2019 i 28 tetorit 2019; dhe A.nr.381/2019 i 3 nëntorit 2019] kishte konstatuar se KQZ, sipas LZP-së, nuk duhet t'i numërojë pakot e arritura pas afatit të përcaktuar ligjor e as t'i përfshijë ato në rezultatin përfundimtar. Ndërkaq, më pas, Gjykata Supreme kishte rrëzuar vendimmarrjen e PZAP dhe kishte konstatuar se ndonëse qëndron fakti që votat kanë arritur pas afatit ligjor KQZ duhet t'i numërojë ato vota dhe t'i përfshijë në rezultatin përfundimtar. Gjykata Supreme konsideronte se norma ligjore që përcakton afatin, respektivisht neni 96.2 i LZP dhe ai 4.4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 është normë ligjore në **"kolizion"** me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe se rrjedhimisht duhet urdhëruar KQZ-në që t'i numërojë pakot në fjalë përkundër faktit që ato kanë arritur pas afatit ligjor. Pasi që KQZ zbatoi vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme, rezultati zgjedhor i certifikuar nga KQZ më 27 nëntor 2019, përfshin edhe votat e numëruara nga pakot e kontestuara që kishin arritur pas afatit të përcaktuar ligjor.

257. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendoi se Gjykata Supreme në kundërshtim me Kushtetutën ka vendosur të aplikojë drejtpërdrejt instrumentet ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës dhe jo nenin 96.2 të LZP-së dhe nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013. Ai gjithashtu pretendoi se gjykatat e rregullta nuk kanë të drejtë të aplikojnë drejtpërdrejt normat kushtetuese dhe/ose instrumentet ndërkombëtare të parapara në nenin 22 të Kushtetutës, si dhe të interpretojnë normat ligjore në harmoni dhe sipas obligimeve që dalin nga normat kushtetuese, pasi në raste të tilla ekziston një obligim detyrues që sipas nenit 113.8 të Kushtetutës, të referojnë çështjen në Gjykatën Kushtetuese sa herë që ngritët çështja e kushtetutshmërisë së normave ligjore.

258. Gjykata gjatë trajtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, fillimisht gjeti se sipas interpretimit të nenit 102.3 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 112.1 të Kushtetutës si dhe sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit vlerëson që e drejta dhe obligimi për të aplikuar dhe interpretuar Kushtetutën, iu njihet të gjitha gjykatave të Republikës së Kosovës dhe të gjitha autoriteteve publike në Republikën e Kosovës.

259. Megjithatë, Gjykata ritheksoi fuqishëm se kompetenca e "konstatimit" të jo-kushtetutshmërisë së një norme ligjore dhe "shfuqizimit" të një norme ligjore si të papajtueshme me Kushtetutën, është kompetencë ekskluzive e Gjykatës Kushtetuese. Pra, përkundër faktit që Kushtetuta ua njeh gjykatave të rregullta kompetencën e interpretimit të një norme të rangut ligjor në harmoni me një normë të rangut kushtetues dhe/ose aplikimin e drejtpërdrejtë të normës së rangut kushtetues, kjo nuk do të thotë se gjykatat e rregullta mund të konstatojnë ose të shpallin një normë ligjore si normë në kundërshtim me Kushtetutën ose KEDNJ-në. Një kompetencë të tillë, të konstatimit të jo-kushtetutshmërisë dhe të shfuqizimit të një norme ligjore, Kushtetuta nuk e ka paraparë si kompetencë për gjykatat e rregullta. Një të drejtë të tillë, Kushtetuta ia ka mveshur në mënyrë ekskluzive vetëm Gjykatës Kushtetuese e cila mund, pas paraqitjes së kërkesës nga një palë e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës, të shfuqizojë një normë ligjore që është në kundërshtim me Kushtetutën si dhe të përcaktojë efektet e një shfuqizimi të tillë.

260. Sa i përket pajtueshmërisë së vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke marrë për bazë parimet e përgjithshme përkitazi me votimin nga jashtë të vendosura nga GJEDNJ, Gjykata theksoi se megjithëse koha për vendimmarrje në konteste zgjedhore është relativisht e shkurtër dhe se e drejta për një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së nuk aplikohet në kontestet zgjedhore, kjo nuk nënkupton që vendimet që ndërlidhen me konteste zgjedhore nuk duhet të jenë mjaftueshëm të arsyetuara. Sipas GJEDNJ-së, procedura e shqyrtimit të kontesteve zgjedhore duhet të përfshijë patjetër një *"vendim mjaftueshëm të arsyetuar"* në mënyrë që *"të parandalohet abuzimi i pushtetit nga autoriteti relevant vendimmarrës"*.

261. Pas aplikimit të këtyre parimeve, Gjykata vlerësoi se arsyetimi i Gjykatës Supreme dhe përfundimet e arritura bazuar në atë arsyetim ishin arbitrare dhe nuk plotësonin asnjë nga kriteret e një vendimi mjaftueshëm të arsyetuar gjyqësor. Kjo për faktin se Gjykata Supreme nuk kishte aplikuar asnjë test relevant të shqyrtimit gjyqësor e as nuk

kishte elaboruar asnjë nga çështjet vijuese që ishin relevante dhe të domosdoshme për tu qartësuar në rrethanat e rastit konkret: (i) çfarë nënkupton "parimi i votimit universal" në të cilin ishte thirrur Gjykata Supreme, si ndërlidhet ai parim me të drejtën e votës nga jashtë dhe si është shkelur i njëjti në rrethanat e rastit konkret; (ii) cilat janë obligimet që neni 3 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së vendosë mbi shtetet përkitazi me votimin nga jashtë; dhe (iii) çfarë është saktësisht ajo që e bën afatin e përcaktuar në nenin 96.2 të LZP në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të jetë normë ligjore në kolizion me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

262. Në këtë aspekt, Gjykata vërejti dhe konstatoi se Gjykata Supreme nuk kishte arritur të vërtetojë, në asnjë mënyrë, se si vendimmarrja e PZAP ishte e gabuar dhe se përse linja e arsyetimit të PZAP duhej zëvendësuar me një linjë krejtësisht tjetër që nuk ishte në përputhje me LZP-në dhe praktikën e deritashme zgjedhore. Rrjedhimisht, Gjykata arriti në përfundimin se Gjykata Supreme nuk kishte ofruar arsyetim të mjaftueshëm ligjor e kushtetues dhe se vendimmarrja e saj në rrethana të rastit konkret ishte arbitrare dhe, për rrjedhojë, në kundërshtim me garancitë e nenit 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

263. Për më tepër, sa i përket përputhshmërisë së normës ligjore që kërkonte që votat për votim nga jashtë duhet të arrijnë në KQZ njëzet e katër (24) orë para ditës së votimit, në mënyrë që të njëjtat të mund të numërohen, Gjykata arriti në përfundim se ky kufizimi i të drejtës së votës: (1) ishte një kufizim i paraparë me ligj; (2) ekzistonte një qëllim legjitim që synohej të arrihej me atë kufizim; si dhe (3) ekziston një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit të së drejtës në fjalë dhe qëllimit legjitim që synohej të arrihej. Gjithashtu, Gjykata gjeti se afati i përcaktuar me nenin 96.2 të LZP-së në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013, nuk ishte arbitrar dhe nuk kishte ndikuar në pamundësim të shprehjes së lirë të vullnetit të popullit përkitazi me përfaqësuesit e vet në Kuvend dhe si i tillë ishte në pajtueshmëri me nenin 45 të Kushtetutës dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

264. Si përfundim, Gjykata **njëzëri** konstatoi se: (i) kërkesa është e pranueshme për shqyrtim në merita; (ii) vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme **nuk janë** në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës dhe si të tilla Gjykata i shpallë të pavlefshme; (iii) vendimet e PZAP-së **janë** në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës; (iv) afati ligjor i përcaktuar nga Kuvendi për arritjen e votave nga jashtë përmes nenit 96.2 të LZP-së

në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 ishte një kufizim i të drejtës së votës i cili ishte në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës ngase i njëjti: ishte i paraparë me ligj; kishte një qëllim legjitim që synohej të arrihej me atë kufizim; dhe kishte një marrëdhënie proporcionaliteti ndërmjet kufizimit të kësaj të drejte dhe qëllimit legjitim që synohej të arrihej me atë kufizim; dhe se, në rrethanat e rastit konkret (v) kufizimi i të drejtës së votës (si e drejtë relative dhe jo absolute) me afat nuk ka qenë arbitrar dhe nuk ka ndikuar në pamundësim të shprehjes së lirë të vullnetit të popullit përkitazi me përfaqësuesit e vet në Kuvend.

265. Për sa i takon efekteve të këtij Aktgjykimi, Gjykata sqaroi se ndonëse konstatimi i saj se vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme nuk janë në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës nuk ka efekt prapaveprues në rezultatin e shpallur zgjedhor në rrethanat e rastit konkret, sipas arsyetimeve të dhëna; megjithatë, Aktgjykimi në këtë rast prodhon të paktën katër efekte të rëndësishme, si në vijim: (1) sqarimi i të drejtave dhe obligimeve të gjykatave të rregullta për rastet kur ato ballafaqohen me norma të rangut ligjor që pretendojnë se janë në kolizion me norma të rangut kushtetues; (2) shfuqizimi i dy vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme dhe lënia në fuqi e dy vendimeve të PZAP-së ashtu që, përderisa Kuvendi i Republikës së Kosovës e lë në fuqi nenin 96.2 të LZP-së, të gjitha votat që arrijnë në KQZ pas afatit të paraparë ligjor duhet të deklarohen si vota të pavlefshme dhe nuk duhet të numërohen e as të përfshihen në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve; (3) qartësimi se në rrethanat e rastit konkret nuk ka ekzistuar kolizion në mes të normës së rangut ligjor dhe asaj të rangut kushtetues dhe se, në këtë aspekt, Gjykata Supreme e ka deklaruar kolizionin në fjalë në mënyrë arbitrare, duke tejkaluar kompetencat e saj kushtetuese dhe pa arsyetim të mjaftueshëm dhe adekuat; dhe se (4) gjetja e shkeljes ia mundëson parashtruesit të kërkesës të konsiderojë shfrytëzimin e mjeteve të tjera juridike në dispozicion për realizimin e mëtejmë të të drejtave të tij në përputhje me gjetjet e këtij Aktgjykimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 dhjetor 2020, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se Aktgjykimet [A.A.U.ZH.nr.20/2019 i 30 tetorit 2019; dhe A.A.U.ZH.nr.21/2019 i 5 nëntorit 2019] e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nuk janë në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

III. TË KONSTATOJË që Vendimet [A.nr.375-2/2019 i 28 tetorit 2019; dhe A.nr.381/2019 i 3 nëntorit 2019] e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa janë në përputhshmëri me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

IV. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

V. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VI. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

VII. TË DEKLAROJË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bajram Ljatifi	Arta Rama-Hajrizi

KO95/20, Parashtrues, Liburn Aliu dhe 16 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, të 3 qershorit 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës

KO95/20, Aktgjykim i miratuar më 21 dhjetor 2020, publikuar më 6 janar 2021

Fjalët kyçe: *kërkesë institucionale, humbja e mandatit, vepra penale, shumica e të të gjithë deputetëve, kërkesë e pranueshme*

Kërkesa bazohej në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, nenet 42 [Saktësimi i kërkesës] dhe 43 [Afatet], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 , si dhe në rregullin 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit], të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, të 3 qershorit 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin, parashtruesit e kërkesës pretenduan se nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë], në lidhje me nënparagrafin 6 të paragrafit 3 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve], të Kushtetutës.

Në titullin – **PËRFUNDIME** – të këtij Aktgjykimi, Gjykata përmblodhi esencën e rastit dhe theksoi me sa vijon:

Me datat 28 mars dhe 20 gusht 2019, Etem Arifi ishte dënuar me Aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, me një vit e tre muaj burgim. Më 6 tetor 2019, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Etem Arifi kandidoi dhe u zgjodh deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Më 27 nëntor 2019, KQZ certifikoi rezultatin e zgjedhjeve dhe në listën e deputetëve të certifikuar ishte edhe Etem Arifi. Më 26 dhjetor 2019, u mbajt mbledhja konstituive e Kuvendit ku u konfirmua mandati i Etem Arifit. Që nga ajo kohë, Etem Arifi vazhdoi të ushtronte funksionin e deputetit, edhe pse ndaj tij rëndonte një dënim gjyqësor i formës së prerë, për një vepër penale, me një vit e tre muaj burgim.

Në këtë kërkesë kushtetuese, 17 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestuan kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, për zgjedhjen e Qeverisë, të nxjerrë me 3 qershor 2020. Parashtruesit pretendojnë se Vendimi në fjalë është në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me paragrafin 3 të nenit 95

[Zgjedhja e Qeverisë], në lidhje me nënparagrafin 6 të paragrafit 3 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës. Kjo sepse, sipas parashtruesve, në procedurën e votimit të Vendimit të kontestuar ka marrë pjesë edhe Etem Arifi, vota e të cilit ishte e pavlefshme për shkak të dënimit të tij me një vit e tre muaj burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Gjykata vlerëson se çështja themelore që ngërthen kjo kërkesë është se a kishte pasur mandat të vlefshëm Etem Arifi në kohën e nxjerrjes në Kuvend të Vendimit të kontestuar për zgjedhjen e Qeverisë (në votimin e të cilit ai kishte marrë pjesë).

Në lidhje me këtë çështje, Gjykata mori parasysh: përgjigjet e dorëzuara nga shtetet anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, qëndrimet e Komisionit të Venecias; si dhe praktikën e mëhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për situata të ngjashme.

Për sa i përket dispozitave kushtetuese dhe ligjore në Republikën e Kosovës, që i japin përgjigje çështjeve të ngritura nga kjo kërkesë, Gjykata gjeti se:

a. Neni 71.1 i Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 29.1(q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcakton se asnjë person nuk mund të jetë kandidat për deputet për zgjedhjet për Kuvend nëse është dënuar për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë në tri vitet e fundit;

b. neni 70.3 (6) i Kushtetutës përcakton se mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm nëse ai/ajo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, me një ose më shumë vite burgim. Ky përcaktim kushtetues përforcohet edhe me nenin 8.1.6 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, nenin 112.1.a të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenin 25.1.d të Rregullores së Kuvendit;

Gjykata konsideron se, për sa i përket të drejtës për kandidim në zgjedhje parlamentare, nenet 45, 55 dhe 71.1 të Kushtetutës duhet lexuar në mënyrë të ndërlidhur. Kështu, neni 45 i Kushtetutës flet përgjithësisht për të drejtat zgjedhore, duke përcaktuar në mënyrë të përgjithësuar se ato mund të kufizohen me vendime gjyqësore kurse neni 55 përcakton kushtet kumulative në bazë të të cilave mund të kufizohen të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë. Ndërsa neni 71 i Kushtetutës – i cili flet ekskluzivisht për "kualifikimet" për të kandiduar për deputet të Kuvendit – përcakton se secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë vjeç ose më i madh dhe <u>përmbush kriteret ligjore</u>, mund të jetë kandidat për deputet. Këto "kriteret ligjore", të cilave iu referohet neni 71 i Kushtetutës, i përcakton Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili në nenin 29.1 (q) thekson

qartë dhe shprehimisht se asnjë person nuk mund të jetë kandidat për deputet për zgjedhje për Kuvend, nëse është dënuar për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë në tri vitet e fundit. Ky përcaktim kushtetues dhe ligjor është në linjë edhe me praktikën që ndiqet nga shumë vende demokratike, siç vërehet edhe nga dokumentet përkatëse të Komisionit të Venecias, si dhe nga përgjigjet e vendeve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias.

Gjykata thekson se normat e mësipërme kushtetuese dhe ligjore, të cilat kanë të bëjnë me pamundësinë (papërshtatshmërinë) për t'u kandiduar për deputet në zgjedhjet e përgjithshme, si dhe me mbarimin apo pavlefshmërinë e mandatit të deputetit, si pasojë e dënimit me burgim për kryerjen e veprave penale, nuk duhen parë si qëllim në vetvete. Në thelb, këto norma nuk kanë synim parësor ndëshkimin e individëve të caktuar duke ua pamundësuar atyre ushtrimin e funksionit të deputetit, por kanë si qëllim themelor mbrojtjen e integritetit kushtetues dhe besueshmërisë qytetare në organin ligjdhënës, si shtyllë e demokracisë parlamentare.

Gjykata konsideron se besueshmëria qytetare në Kuvendin e Republikës së Kosovës cenohet nëse – pavarësisht ndalesave që vë neni 71 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – lejohet që mandatin e deputetit ta fitojë dhe ta ushtrojë një person që është dënuar për vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë të vlefshëm në Republikën e Kosovës.

Në lidhje me këtë, Gjykata sjellë në vëmendje Raportin e Komisionit të Venecias, i cili thekson se *"ligjshmëria është element i Sundimit të Ligjit dhe nënkupton që ligji duhet të respektohet nga individët dhe autoritetet. Ushtrimi i funksionit politik nga personat të cilët kanë shkelur ligjin në mënyrë serioze vendos në rrezik zbatimin e këtij parimit [sundimit të ligjit], që është njëri nga parakushtet e demokracisë, dhe për këtë arsye rrezikon natyrën demokratike të shtetit"*. (Shih Raportin e Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave të Paligjshme nga Parlamenti, CDL-AD(2015)036, i 23 nëntorit 2018, paragrafi 168).

Në këtë frymë, Gjykata vlerëson se është kërkesë e qartë kushtetuese e mishëruar në nenin 71.1 në ndërlidhje me nenin 70.3 (6) të Kushtetutës, se është e papajtueshme me Kushtetutën që një person ta fitojë dhe ta mbajë mandatin e deputetit nëse është i dënuar për vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë, siç është përcaktuar me këto dispozita. Kjo kërkesë përforcohet me nenet 29 dhe 112 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenin 8.1.6 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë Deputetit.

Më tutje, Gjykata thekson se fakti që neni 70.3 (6) i Kushtetutës, neni 8.1.6 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe neni 112.1 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i referohen dënimit të deputetit (pra dënimit pasi ai ta ketë fituar mandatin), është reflektim i prezumimit se neni 29.1 (q) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili mbështetet në nenin 71.1 të Kushtetutës, nuk lejon që një person i dënuar me burgim gjatë tri viteve të fundit para zgjedhjeve të kandidojë për deputet dhe të fitoj mandatin e deputetit.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në gjuhën e qartë të nenit 71.1 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nënparagrafit 6 të paragrafit 3 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata konsideron se asnjë person nuk mund të fitojë dhe mbajë mandat të vlefshëm të deputetit nëse është i dënuar për vepër penale sikurse parashihet me këto dispozita, me vendim gjyqësor të formës së prerë, nëse kundër tij/saj ka një vendim dënues që është në fuqi në Republikën e Kosovës.

Gjykata vëren sqarimin e KQZ-së se sipas Aktgjykimit AA.-Uzh.nr.16/2017, të 19 shtatorit 2017 të Gjykatës Supreme, *"askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje, nëse një e drejtë e tillë nuk i është hequr me vendim gjyqësor, e që don të thotë, se kandidati duhet me vendim të formës së prerë, të shpallet fajtor dhe gjykata, t'i ketë shqiptuar dënimin plotësues "heqjen e të drejtës për tu zgjedhur"*.

Megjithatë, Gjykata konsideron se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk kërkon që personave të dënuar për vepra penale t'iu shqiptohet medoemos si dënim plotësues *"heqja e të drejtës për t'u zgjedhur"*, në mënyrë që ata të mos lejohen të kandidojnë në zgjedhje parlamentare. Kjo meqë, sipas nenit 29.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ndër të tjera, parashihen edhe këto dy baza: (i) heqja e të drejtës për të qenë kandidat në zgjedhje me vendim të PZAP-it dhe gjykatës; si dhe (ii) pamundësia për të qenë kandidat për shkak të shpalljes fajtor për një vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit. Këto janë baza të ndryshme/të ndara që shkaktojnë pamundësinë/papërshtatshmërinë për të qenë kandidat. Gjykata është e mendimit se ky interpretim përputhet edhe me leximin e ndërlidhur të neneve 45, 55 dhe 71 të Kushtetutës.

Gjykata konsideron të rëndësishme të vë në dukje se kandidimi në zgjedhje parlamentare i Etem Arifit, zgjedhja e tij si deputet dhe ushtrimi i mandatit të deputetit – të gjitha këto pasi që ai ishte dënuar me një vit e tre muaj burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë – shpërfaqin ekzistimin e paqartësisë normative dhe të metave serioze në mekanizmat institucionalë të Republikës së Kosovës, që janë kompetent për të garantuar ligjshmërinë dhe integritetin kushtetues të proceseve zgjedhore dhe veprimtarisë

parlamentare. Kjo paqartësi është e dukshme edhe në përgjigjet që janë dhënë nga trupat përkatës të Kuvendit dhe nga KQZ-ja.

Në lidhje me këtë, Gjykata potencon nevojën që Kuvendi i Republikës së Kosovës me komisionet e tij, në bashkëveprim me institucionet gjegjëse, duke përfshirë edhe KGJK-në dhe KQZ-në, të qartësojnë dhe konsolidojnë bashkëpunimin ndër-institucional dhe aspektet normative që kanë të bëjnë me kandidimin në zgjedhje parlamentare dhe ushtrimin e mandatit të deputetit, nga ana e personave të dënuar për vepra penale.

Kjo është e domosdoshme për të shmangur situatat paradoksale, nga këndvështrimi kushtetues, ku një person, pasi është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë sikurse parashihet me nenet përkatëse të Kushtetutës dhe ligjeve, i lejohet të kandidojë në zgjedhje parlamentare, të zgjidhet deputet, t'i verifikohet mandati, si dhe të vazhdojë të ushtrojë funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, madje edhe gjatë vuajtjes së dënimit me burgim. Ndërkohë që Kushtetuta dhe ligjet përkatëse vënë barriera të qarta normative për të mos lejuar personat e dënuar me burgim për kryerjen e veprave penale, që të zgjedhën deputet dhe të ushtrojnë mandatin e deputetit.

Për sa i përket zgjedhjes së Qeverisë, Gjykata thekson se në mënyrë që Qeveria të zgjidhet, konform paragrafit 3 të nenit 95 të Kushtetutës, "për" Qeverinë duhet të votojnë të paktën gjashtëdhjetë e një (61) deputetë të Kuvendit. Në rastin konkret, sipas dokumenteve zyrtare të Kuvendit, Gjykata vëren se më 3 qershor 2020, gjashtëdhjetë e një (61) deputetë kishin votuar *"për"* Qeverinë, gjegjësisht për vendimin e kontestuar. Për miratimin e Vendimit të kontestuar kishte votuar edhe Etem Arifi. Pasi Gjykata gjeti se mandati i Etem Arifit kishte qenë i pavlefshëm para votimit të Vendimit të kontestuar, ai Vendim kishte marrë vetëm gjashtëdhjetë (60) vota të vlefshme. Për pasojë, procedura për të zgjedhur Qeverinë nuk është zhvilluar në përputhje me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, sepse Qeveria nuk ka marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Gjykata vë në pah se neni 95 i Kushtetutës, siç është interpretuar përmes praktikës së saj gjyqësore, parasheh dy tentativa për të zgjedhur Qeverinë nga Kuvendi. Në të dyja rastet, Qeveria për t'u konsideruar e zgjedhur duhet të këtë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht gjashtëdhjetë e një (61) vota. Nëse as pas tentimit të dytë nuk zgjidhet Qeveria, neni 95.4 i Kushtetutës parasheh shpalljen e zgjedhjeve nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Gjykata rikujton që Qeveria e votuar përmes Vendimit nr. 07/V-014 të Kuvendit, të 3 qershorit 2020, është bazuar në Dekretin e Presidentit nr.

24/2020, të datës 30 prill 2020, të nxjerrë bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, përkatësisht në tentativën e dytë për zgjedhjen e Qeverisë. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton interpretimin e dhënë në Aktgjykimin KO72/20 ku kishte theksuar se *"zgjedhjet do të jenë të pa evitueshme në rast të dështimit të zgjedhjes së Qeverisë edhe në tentativën e dytë, [...] me ç'rast, bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, Presidenti shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre"*.

Në dritën e kësaj, Gjykata thekson se në rastin konkret vihet në lëvizje paragrafi 4 i nenit 95 të Kushtetutës, sipas të cilit Presidenti i Republikës së Kosovës shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.

Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksojë se është e vetëdijshme se Etem Arifi ka marrë pjesë edhe në procedura të tjera votuese në Kuvend, edhe pasi ai nuk kishte mandat të vlefshëm. Megjithatë, duke u mbështetur në parimin *non ultra petita* ("jo përtej kërkesës"), Gjykata kufizohet në vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar më kërkesën e paraqitur para saj, gjegjësisht Vendimit nr. 07/V-014, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkitazi me Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjykata e sheh të nevojshme që të sqarojë po ashtu se, duke u nisur nga parimi i sigurisë juridike, si dhe nga fakti se ky Aktgjykim nuk mund të ketë efekt prapaveprues, vendimet e Qeverisë aktuale mbeten në fuqi, si dhe Qeveria mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO95/20

Parashtrues

Liburn Aliu dhe 16 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, të 3 qershorit 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Liburn Aliu, Hekuran Murati, Hajrullah Çeku, Saranda Bogujevci, Jahja Koka, Valon Ramadani, Mimoza Kusari Lila, Fitim Uka, Shpejtim Bulliqi, Artan Abrashi, Alban Hyseni, Gazmend Gjyshinca, Enver Haliti, Agon Batusha, Dimal Basha, Fjolla Ujkani dhe Elbert Krasniqi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi).

2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar deputetin e Kuvendit, Artan Abrashi, që t'i përfaqësojë ata në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

Akti i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, të 3 qershorit 2020, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: vendimi i kontestuar).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet se nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë], në lidhje me nënparagrafin 6 të paragrafit 3 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, nenet 42 [Saktësimi i kërkesës] dhe 43 [Afatet], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit], të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 qershor 2018, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesën e tyre në Gjykatë. Të njëjtën ditë, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë dokumente shtesë lidhur me rastin, më saktësisht dorëzuan vendimin e kontestuar.

7. Në të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzie Istrefi-Peci (anëtarë).

8. Më 15 qershor 2020, parashtruesit e kërkesës u njoftuan për regjistrimin e kërkesës.

9. Po të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Presidentit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Presidenti), Kryeministrit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryeministri), Avokatit të Popullit, si dhe Kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në

tekstin e mëtejmë: KQZ), me udhëzimin që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet, nëse kanë, deri më 29 qershor 2020.

10. Në të njëjtën ditë, pra më 15 qershor 2020, kërkesa iu komunikua edhe Kryetares së Kuvendit, të cilës iu kërkua që të njoftojë deputetët se mund të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën e parashtruesve, nëse kanë, deri më 29 qershor 2020.

11. Më 17 qershor 2020, Gjykata kërkoi nga Sekretaria e Kuvendit që, deri me datë 29 qershor 2020, t'i dorëzojë Gjykatës të gjitha dokumentet e rëndësishme për vendimin e kontestuar, si dhe të informojë Gjykatën nëse ekzistojnë praktika të mëhershme në Kuvend lidhur me mbarimin ose pavlefshmërinë e mandatit të deputetëve të akuzuar apo dënuar për vepra penale.

12. Më 24 qershor 2020, Sekretaria e Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentet relevante lidhur me vendimin e kontestuar, si dhe informoi Gjykatën lidhur me procedurën e ndjekur nga Kuvendi, në vitin 2016, në rastin e deputetit Rr. M., i cili kishte humbur mandatin e deputetit të Legjislaturës së V-të të Kuvendit dhe ishte zëvendësuar, për shkak se ishte dënuar për vepër penale.

13. Më 9 korrik 2020, Gjykata kërkoi nga Sekretaria e Kuvendit që, deri më 16 korrik 2020, t'i dorëzojë Gjykatës dokumentet si në vijim: *a)* Raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, të themeluar përmes Vendimit nr. 07-V-001, për verifikimin e kuorumit në seancë konstituive dhe vlefshmërinë e mandatit të deputetëve, të Legjislaturës së VII-të të Kuvendit, të paraqitur më 26 dhjetor 2019; dhe *b)* Procesverbalin e mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës se Kosovës, të mbajtur me datë 26 dhjetor 2019.

14. Më 9 korrik 2020, Gjykata kërkoi nga KQZ që, deri me datë 16 korrik 2020, të dorëzojë informacion në Gjykatë lidhur me: *a)* procedurën që ndiqet në KQZ për certifikimin e kandidatëve/listës së kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhjet e përgjithshme, sidomos në ndërlidhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 29.1.(q) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256; dhe *b)* nëse ekziston ndonjë procedurë apo veprim i veçantë që ndërmerr KQZ-ja për të parandaluar që personave të dënuar për vepra penale me vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit të mos iu mundësohet të kandidohen dhe zgjidhen deputet të Kuvendit te Republikës se Kosovës, si dhe kërkoi nga KQZ-ja që ta informojë Gjykatën nëse ka pasur raste të tilla në të kaluarën.

15. Më 13 korrik 2020, Sekretaria e Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentet si në vijim: *a)* Raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, të datës 26.12.2019; *b)* Procesverbalin e Seancës Konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 26 dhjetor 2020; dhe *c)* Transkriptin e Mbledhjes Konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 26 dhjetor 2019.

16. Më 16 korrik 2020, KQZ dorëzoi përgjigjen në kërkesën për informata të kërkuara nga Gjykata.

17. Më 20 korrik 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës, Presidentin, Kryeministrin dhe Kryetaren e Kuvendit, lidhur me përgjigjet e pranuara nga Sekretaria e Kuvendit dhe KQZ-ja. Kryetares së Kuvendit iu kërkua që të njoftojë të gjithë deputetët për përgjigjet e pranuara lidhur me kërkesën.

18. Me 7 gusht 2020, Gjykata i kërkoi Sekretarisë së Kuvendit që, deri me datë 10 gusht 2020, të dorëzonte në Gjykatë Opinionin Ligjor që Drejtoria për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit e Kuvendit ia ka paraqitur Kryetares së Kuvendit lidhur me çështjen e Etem Arifit (duke qenë se ky dokument mungonte nga dosja e paraqitur nga Sekretaria e Kuvendit).

19. Me 7 gusht 2020, Gjykata pranoi një njoftim nga Sekretaria e Kuvendit ku sqarohej se: "*Opinioni Ligjor, lidhur me Mandatin e Deputetit Etem Arifi, datë 18 maj 2020, i Drejtorisë për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit, është dokument i brendshme që i është adresuar Kryesisë së Kuvendit.*" Rrjedhimisht, Gjykatës nuk iu dorëzua dokumenti në fjalë.

20. Më 2 shtator 2020, në seancën e saj të rregullt, Gjykata shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe vendosi që të shtyhet vendimmarrja ashtu që të kërkohen informata shtesë lidhur me rastin, nga Kuvendi dhe KGJK-ja.

21. Më 7 shtator 2020, Gjykata kërkoi nga KGJK-ja që deri më 14 shtator 2020, ta informojë Gjykatën *"lidhur me datën kur Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, PAKR, nr. 328/19, i 20 gushtit 2019, ka marrë formën e prerë sipas legjislacionit në fuqi."*

22. Më 8 shtator 2020, Gjykata kërkoi nga Kryetarja e Kuvendit që, deri më 15 shtator 2020, të dorëzojë në Gjykatë Opinionin Ligjor që Drejtoria për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit e

Kuvendit ia ka paraqitur Kryetares se Kuvendit, lidhur me çështjen e Etem Arifit.

23. Më 10 shtator 2020, KGJK dorëzoi përgjigjen në kërkesën për informatat e kërkuara nga Gjykata.

24. Më 15 shtator 2020, Kuvendi dorëzoi në Gjykatë Opinionin Ligjor të Drejtorisë për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit të Kuvendit, të 18 majit 2020, lidhur me çështjen e Etem Arifit.

25. Më 28 tetor 2020, Gjykata shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe vendosi që rasti të shtyhet për shqyrtim në një nga seancat e radhës, me kërkesën që i njëjti të plotësohet. Në të njëjtën seancë u vendos për mbajtjen e seancës dëgjimore publike dhe dërgimin e pyetjeve, lidhur me rastin, në Forumin e Komisionit të Venecias.

26. Më 17 nëntor 2020, Gjykata iu dërgoi ftesat për pjesëmarrje në seancën dëgjimore publike, parashtruesve të kërkesës, Kryetares së Kuvendit, Kryeministrit, Kryetarit të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë: Komisioni për Legjislacion, Mandate dhe Imuniteti); Kryetares së KQZ-së; dhe Kryetarit të KGJK-së.

27. Më 23 nëntor 2020, Gjykata parashtroi në Forumin e Komisionit të Venecias pyetjet në vijim:

"a) A lejon korniza ligjore në vendin tuaj që personat e dënuar për vepër penale të mund të kandidohen për zgjedhje për anëtarë të Parlamentit?

b) Cili është momenti kur mandati i anëtarit të Parlamentit, i dënuar me vendim të prerë të gjykatës, konsiderohet se ka humbur/përfunduar?

c) A vazhdon Parlamenti të punojë dhe të marrë vendime në periudhën ndërmjet momentit në të cilën mandati i deputetit ka përfunduar/humbur dhe momentit në të cilën mandati i tij/saj është zëvendësuar/plotësuar?

d) Në rast se Parlamenti vazhdon të punojë ndërsa deputeti, i cili ka humbur mandatin nuk është zëvendësuar ende, cili konsiderohet numri i përgjithshëm i deputetëve të Parlamentit për qëllimin e "shumicës së votave të të gjithë anëtarëve të Parlamentit"? A llogariten votat e nevojshme bazuar në numrin e

përgjithshëm të mandateve/vendeve të Parlamentit, apo vetëm bazuar në numrin e përgjithshëm të mandateve/vendeve të vlefshme në një moment specifik?

e) Cilat janë pasojat ligjore, për vendimin e miratuar nga Kuvendi, në rast se një anëtar i tij, i cili konsiderohet të ketë pasur mandat të pavlefshëm ka marrë pjesë në procedurën e marrjes së vendimit nga Parlamenti dhe vota e tij/saj ishte vendimtare që vendimi të miratohet?"

28. Ndërmjet 29 nëntorit 2020 dhe 15 dhjetorit 2020, Gjykata pranoi përgjigje në pyetjet e parashtruara nëpërmjet Forumit të Komisionit të Venecias nga gjykatat kushtetuese/supreme të shteteve në vijim: Suedisë, Sllovakisë, Kroacisë, Republikës Çeke, Meksikës, Brazilit, Kirgizisë, Holandës, Bullgarisë dhe Polonisë.

29. Më 2 dhjetor 2020, u mbajt seanca dëgjimore publike, përmes platformës elektronike. Në këtë seancë morën pjesë dhe u dëgjuan: përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës; përfaqësuesi i Kryetares së Kuvendit; përfaqësuesi i Kryeministrit; Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete; Kryetarja e KQZ-së; dhe përfaqësuesi i Kryetarit të KGJK-së.

30. Më 7 dhjetor 2020, Gjykata pranoi komente lidhur me seancën dëgjimore nga përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dhe përfaqësuesi i Kryeministrit. Të njëjtën ditën, komente dhe sqarime lidhur me rastin paraqiti edhe përfaqësuesi i Etem Arifit.

31. Më 21 dhjetor 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

32. Në të njëjtën ditë, Gjykata votoi dhe njëzëri vendosi se Vendimi nr. 07/V-014 i Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i 3 qershorit 2020, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, sepse nuk ka marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.**Përmbledhja e fakteve**

Përmbledhja e fakteve lidhur me dënimin penal ndaj Etem Arifit

33. Më 20 prill 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin PKR.740/16, shpalli Etem Arifin fajtor për arsye se në bashkëkryerje (me personin B.G) kishte kryer veprën penale "*Mashtrim me*

subvencione", nga neni 336, paragrafi 3, në lidhje me nenin 31, të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK). Në atë kohë Etem Arifi ishte deputet i legjislaturës së kaluar të Kuvendit (gjegjësisht legjislaturës së VI-të) dhe ai u zgjedh përsëri deputet i Kuvendit, në zgjedhjet e 6 tetorit 2019. Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, Etem Arifi u dënua me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, i cili vendim nuk do të ekzekutohej me kusht që ai brenda afatit kohor prej tre (3) viteve nuk do kryente ndonjë vepër tjetër penale. Gjykata Themelore, gjithashtu, detyroi Etem Arifin dhe të dënuarin tjetër (B.G) që për dëmin e shkaktuar t'ia kompensojnë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në mënyrë solidare në afat prej 6 muajsh, shumën prej 22.900 euro, si dhe Zyrës së Kryeministrit shumën prej 2.749 euro.

34. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, kishin parashtruar ankesë Etem Arifi si dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.

35. Më 28 mars 2019, Gjykata e Apelit e Kosovës, përmes Aktgjykimit PAKR.nr.328/2018, vendosi që: "*I.* [...] *ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore* [...] *në pjesën gjykuese sa i përket vendimit për dënimin dhe detyrimin përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale ashtu që kjo Gjykatë gjen se në veprimet e të akuzuarve Etem Arifi dhe* [B.G] *të përshkruara në dispozitivin nën I të aktgjykimit formohen elementet e veprës penale mashtrimi me subvencione, nga neni 336 par 3.lidhur me par 2 e 1 të nenit 31 të KPRK dhe për këtë vepër penale i gjykon të akuzuarin me (1) vit e (3) muaj burgim* [...] *obligohen që të t'ia kompensojnë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në emër të dëmit të shkaktuar shumën prej 22.900€, kurse Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës- Zyrës për komunitete shumën prej 2.749 ë në afat prej gjashtë muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.*"

36. Etem Arifi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit PAKR.nr.328/2018, të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Pml.nr.168/2018, të 20 qershorit 2019, kishte rikthyer rastin e Etem Arifi (dhe personit B.G), në rishqyrtim në Gjykatën e Apelit, për shkak se "*përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin*".

37. Më 20 gusht 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit PAKR, nr.328/19, duke vepruar në rigjykim, vendosi si në vijim:

I. Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës

Themelore DKR ne Prishtinë, PKR.nr.740116 i datës 20.04.2018 ne pjesën gjykuese sa i përket vendimit mbi dënimin [...], dhe për këtë vepër penale i gjykon te akuzuarin Etem Arifi me 1 vit e 3 muaj burgim[...].

II. Të akuzuarit Etem Arifi e [B.G] , obligohen ti kompensojnë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në emër të dëmit të shkaktuar shumën prej 22.900 euro, ndërsa Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës-Zyra për Komunitete shumën prej 2.749 euro, të gjitha në afat prej 3 muajve.

III. Me aprovimin e ankesës se PSRK-së, e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi në pjesën lirues përkitazi me të akuzuarin Etem Arifi anulohet dhe lënda i kthehet Gjykatës Themelore DKR-në Prishtinë në rigjykim.

IV. Ankesat te mbrojtësve e te akuzuarve, refuzohen si të pabazuara.

38. Sipas shkresave të lëndës rezulton se Aktgjykimin PAKR.nr.328/19, të Gjykatës së Apelit, Etem Arifi e kishte pranuar më 9 nëntor 2019.

39. Më 18 nëntor 2019, Etem Arifi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, PKR.nr.740/16, të 20 prillit 2018, si dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR 328/19, të 20 gushtit 2019, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të kodit penal.

40. Më 30 janar 2020, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin PML. Nr. 380/2019, refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga Etem Arifi.

41. Më 27 prill 2020, Etem Arifi paraqiti në Gjykatën Kushtetuese kërkesë (KI71/20) për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme.

42. Në një datë të pasaktësuar, Gjykata Themelore ka lëshuar urdhëresë për arrestimin, ndalimin dhe dërgimin në vuajtje të dënimit të Etem Arifit.

43. Më 23 shtator 2020, Gjykata Kushtetuese shpalli kërkesën KI71/20, të Etem Arifit, të papranueshme si qartazi të pabazuar.

44. Aktualisht, Etem Arifi është në vuajtje të dënimit.

Përmbledhja e fakteve lidhur me vendimin e kontestuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës

45. Më 26 gusht 2019, Presidenti i Republikës së Kosovës nxori Vendimin nr. 236/2019, për caktimin dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat u caktuan për datën 6 tetor 2019.

46. Më 27 gusht 2019, KQZ nxori Vendimin nr. 824-2019, për Caktimin e Afateve të Aktiviteteve Zgjedhore për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pika II e këtij Vendimit parashihte, mes tjerash, se:

> *"[...]*
> *e) [Afati] për aplikim për certifikim i subjekteve politike dhe kandidatëve fillon me 27 gusht dhe përfundon më 06 shtator 2019.*
> *[...]*
> *g) Certifikimit i subjekteve politike dhe kandidateve fillon me 5 shtator dhe përfundon më 10 shtator 2019.*
> *[...]*
> *i) Afati i fundit për tërheqjen e kandidatëve nga shorti i fletëvotimeve dhe afati i zëvendësimin e kandidatëve 08 shtator deri me 17 shtator 2019."*

47. Më 6 tetor 2019, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

48. Më 27 nëntor 2019, KQZ certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend, përmes Vendimit nr. 1845/2019, bazuar në listën vijuese të rezultateve të zgjedhjeve:

a. Lëvizja VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejmë: LVV), 29 deputetë;
b. Lidhja Demokratike e Kosovës, 28 deputetë;
c. Partia Demokratike e Kosovës, 24 deputetë;
d. AAK-PSD Koalicioni 100% Kosovë, 13 deputetë;
e. Srpska Lista, 10 deputetë;
f. Nisma Socialdemokrate – Aleanca Kosova e Re, Partia e Drejtësisë, 6 deputetë;
g. Koalicija "Vakat", 2 deputetë;
h. Kosova Demokratik Tyrk Partisi, 2 deputetë;
i. Partia Liberale Egjiptiane, 1 deputet;
j. Nova Demokratska Stranka, 1 deputet;
k. Partia e Ashkalinjëve për Integrim, 1 deputet;
l. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, 1 deputet;
m. Jedinstvena Goranska Partija, 1 deputet;

n. Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, 1 deputet.

49. Në listën e deputetëve të certifikuar nga KQZ ishte përfshirë edhe Etem Arifi nga Partia e Ashkalinjëve për Integrim.

50. Më 26 dhjetor 2019, u mbajt mbledhja konstituive e Kuvendit, me tri pika të rendit të ditës:

1. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve;
2. Dhënia e betimit të deputetëve;
3. Zgjedhja e Kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit.

51. Në të njëjtën mbledhje, përmes Vendimit nr. 07-V-001, Kuvendi formoi Komisionin e Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, i përbërë nga 14 anëtarë (deputet të Kuvendit). Sipas pikës II të këtij Vendimi, *"Komisioni e shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me 6 tetor 2019, për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Kuvendit ia paraqet raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit, si dhe e verifikon kuorumin në seancën konstituive të Legjislaturës VII të Kuvendit."*

52. Në të njëjtën ditë, më 26 dhjetor 2019, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, duke u mbështetur në Vendimin e KQZ-së nr. 1845/2019, datë 27 nëntor 2019, së bashku me listën përfundimtare të kandidatëve, paraqiti Raportin duke konstatuar se "*në Legjislaturën VII për Kuvendin e Republikës së Kosovës janë certifikuar 120 deputetë nga partitë politike, koalicionet, iniciativa qytetare që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e mbajtura më 6 tetor 2019*". Etem Arifi ishte njëri nga personat të cilëve iu konfirmua mandati si deputet. Pas kësaj, deputetët dhanë betimin (duke përfshirë edhe Etem Arifin), si dhe me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve u konstitua Kuvendi.

53. Më 3 shkurt 2020, Kuvendi zgjodhi Qeverinë me Kryeministër z. Albin Kurti.

54. Më 20 mars 2020, një numër i deputeteve të Kuvendit dorëzuan në Kryesinë e Kuvendit Mocionin e Mosbesimit ndaj Qeverisë.

55. Më 25 mars 2020, Kuvendi, përmes Vendimit nr. 07-V-013, miratoi Mocionin e Mosbesimit ndaj Qeverisë.

56. Me 30 prill 2020, pas disa letërkëmbimeve dhe pas kërkesës së Presidentit (përmes shkresës Nr. Prot. 382/1), me të cilën iu drejtua Kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës për të propozuar mandatarin për formimin e Qeverisë, Lidhja Demokratike e Kosovës propozoi z. Avdullah Hoti si kandidat për Kryeministër të Republikës së Kosovës.

57. Më 30 prill 2020, Presidenti nxori Dekretin nr. 24/2020, me të cilin *"Z. Avdullah Hoti i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës."*

58. Po atë ditë, 30 deputetë të Kuvendit të Kosovës kërkuan nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020, për propozimin e Avdullah Hotit si kandidat për Kryeministër të Republikës së Kosovës.

59. Të njëjtën ditë, pra më 30 prill 2020, Kryetarja e Kuvendit kërkoi nga KGJK që t'i dërgojë në Kuvend të gjitha informatat dhe dokumentet lidhur me rastin e Etem Arifit.

60. Nga shkresat e lëndës rezulton se, më 30 prill 2020, Kryetarja e Kuvendit kishte pranuar një shkresë (Memorandum sqarues) nga mbrojtësi ligjor i Etem Arifit, në lidhje me mandatin e këtij të fundit. Në këtë shkresë, ndër të tjera, theksohet se: "*Mandati i z. Etem Arifi [..] është i ligjshëm dhe në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës pasi që i njëjti nuk është dënuar me vendim të plotfuqishëm nga gjykata gjatë këtij mandati (Legjislaturës VII) ndërsa dënimi i shqiptuar sipas Aktgjykimit 20.08.202 nuk ka paraqitur pengesë në certifikimin e z. Arifi si kandidat për deputet dhe po ashtu nuk paraqet pengesë ligjore në vazhdimin e ushtrimit të mandatit derisa ekzistojnë këto kushte ligjore*".

61. Më 1 maj 2020, pas kërkesës së Kryetares së Kuvendit, KGJK dorëzoi në Kuvend kopjet e aktgjykimeve me të cilat Etem Arifi ishte shpallur fajtor për vepër penale, duke përfshirë Aktgjykimit e Gjykatës së Apelit, PAKR 328/19, të 20 gushtit 2019 dhe Aktgjykimin PML. Nr. 380/20, të Gjykatës Supreme, të 30 janarit 2020.

62. Me 4 maj 2020, Gjykata e Apelit dorëzoi në Kuvend kopjet fizike të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

63. Më 4 maj 2020, Kryetarja e Kuvendit iu drejtuar me shkresë Kryetarit të Komisionit për Legjislacion, Mandate dhe Imuniteti, duke kërkuar "*që të trajtohet çështja e mandatit të deputetit Etem Arifi*".

64. Më 12 maj 2020, Komisioni për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, dorëzoi përgjigjen në kërkesën e Kryetares së Kuvendit, duke sqaruar si në vijim:

> "*Komisioni konstatoi se asnjë dispozitë e Rregullores së Kuvendit nuk flet për rastet kur deputeti e humb mandatin Ipso jure, përveç në rastin siç përcaktohet me nenin 70, paragrafi 3, nënparagrafi 5 i Kushtetutës, së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 paragrafi 1 pika e) e Rregullores së Kuvendit [...]. Pra në bazë të Rregullores së Kuvendit, Komisioni përkatës për Legjislacion, shqyrton çështjen e mandatit të deputetit vetëm në rastet siç përcaktohet me nenin 25 paragrafi 1 pika e) e Rregullores së Kuvendit.*" Komisioni për legjislacion, gjithashtu theksoi se: *"Rekomandohet që në të ardhmen Komisioni i përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve të jetë më proaktiv në verifikimin e mandatit te deputetëve. [...] Andaj duke u bazuar në Konstatimet e theksuara, rekomandohet që të ndiqet praktika e mëparshme e Kuvendit."*

65. Më 28 maj 2020, Gjykata Kushtetuese vendosi që Dekreti i Presidentit, i datës 30 prill 2020, për propozimin e Avdullah Hotit si kandidat për Kryeministër të Republikës së Kosovës, ishte në përputhshmëri me Kushtetutën.

66. Më 3 qershor 2020, Kuvendi, përmes vendimit të kontestuar, nr. 07/V-014, zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës, me 61 vota "për", 24 "kundër" dhe 1 abstenim. Sipas materialit të dorëzuar në Gjykatë, Etem Arifi votoi "për" zgjedhjen e Qeverisë.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

67. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimi i kontestuar nuk është në pajtim me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë], në lidhje me nënparagrafin 6 të paragrafit 3 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve], të Kushtetutës.

68. Parashtruesit në kërkesën e tyre kontestojnë kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar sepse, sipas tyre, *"[...] (i) rezultati i votimit në seancën e jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të datës 03.06.2020, nuk është në përputhje me Nenin 95 par.3; dhe (ii) gjatë procedurës së votimit në seancën e lartcekur të datës 03.06.2020, që ka rezultuar*

në nxjerrjen e Vendimit për krijimin e Qeverise, Kuvendi ka vepruar në kundërshtim me procedurat e parapara në Kushtetutë sipas kuptimit të Nenit 70 par. 3, nënpar. (6), në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, në lidhje me mandatin e deputetit."

69. Parashtruesit e kërkesës argumentojnë shkeljet e pretenduara më lart duke theksuar se *"në seancën e jashtëzakonshme plenare të lartcekur të Kuvendit të datës 03.06.2020, ka qenë i pranishëm dhe ka votuar z. Etem Arifi, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga Partia e Ashkalinjeve për lntegrim (PAI), i cili është i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës në Republikën e Kosovës për veprën penale me dënimin prej 1 vit e 3 muaj. Rrjedhimisht, përbërja e Qeverisë nuk i ka marrë shumicën e nevojshme të votave për zgjedhjen e saj ashtu siç është përcaktuar me Kushtetutë."*

70. Parashtruesit e kërkesës, duke u thirrur në nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], të Kushtetutës, argumentojnë se *"Kushtetuta ashtu sikurse edhe legjislacioni në fuqi, janë të qarta dhe përkufizojnë saktësisht dhe pa dykuptimësi çështjen e të drejtës dhe kufizimeve në lidhje me të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Në këtë përkufizim të garantimit të së drejtës zgjedhore, bën pjesë edhe çështja e mandatit te deputetit."* Ata më tej shtojnë se *"Kushtetutbërësi i Kosovës, për të mos lënë asnjë hapësirë arbitrariteti për keqpërdorim të çfarëdo pushteti shtetëror sa i përket njërës nga të drejtat themelore të njeriut, të drejtës zgjedhore edhe për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar segmentet përmasat si dhe mënyrën e kufizimit, që mund të bëhet vetëm me "vendim gjyqësor".*

71. Parashtruesit e kërkesës, duke u thirrur në nenin 70 [Mandati i Deputetëve], paragrafi 3,të Kushtetutës, pohojnë se "[...] *deputeti i Kuvendit z. Etem Arifi është i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, rrjedhimisht vota e tij duhet të shpallet e pavlefshme, për shkak se sipas nenit 70 par 3 nënpar (6) të Kushtetutës atij i ka mbaruar mandati i deputetit".* Sipas parashtruesve të kërkesës, neni 70 [Mandati i Deputetëve] përcakton qartë kriteret kushtetuese, lidhur me faktin se kur mbaron mandati i deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

72. Parashtruesit e kërkesës më tej sqarojnë se "*për vendimin e Gjykatës së Apelit me të cilin është dënuar deputeti z. Etem Arifi me 1 vit e 3 muaj burg, Kuvendi është njoftuar për herë të parë në muajin prill 2020. Kësisoj, sipas parimit të standardit juridik të përgjithshëm, efektet e vendimit fillojnë të prodhojnë pasoja juridike në momentin që pala, në këtë rast Kuvendi, është njohur me pasojat e këtij vendimi.*

Prandaj, parashtruesit pretendojnë se vota e deputetit në fjalë duhet të shpallet e pavlefshme në përputhje me nenin 70 par.3 nen.(6) të Kushtetutës. Rrjedhimisht, nga aspekti procedural, vendimi i Kuvendit Nr. 07-V-014. i datës 03.06.2020, duhet te konsiderohet kundërkushtetues për faktin se përbërja e Qeverisë nuk ka marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, siç përcaktohet në nenin 95 par.3 të Kushtetutës."

73. Parashtruesit e kërkesës i referohen gjithashtu edhe nenit 112 [Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendit], par 1, të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256 (më tutje: Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme), si dhe nenit 8 [Përfundimi i Mandatit], pikën 1.6, të Ligjit Nr.03/L-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit (më tutje: Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit), të cilat parashohin se mandati i deputetit përfundon kur ai/ajo dënohet për vepër penale ashtu si është paraparë në nenin 70, paragrafi 3, të Kushtetutës.

74. Parashtruesit e kërkesës, për më tepër, pohojnë se "*Edhe Neni 25, pika d) e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, bartë po të njëjtën frymë të Kushtetutës, të cilën e bartë Ligji Nr.03/L-111 sikur ne paragrafin paraprak te kësaj Kërkese. Përjashto dallimet gjuhësore për të shprehur qëllimin e njëjtë të normës, thelbi i frymës kushtetuese dhe ligjore është arsyeja e humbjes se mandatit [...]*"

75. Parashtruesit e kërkesës, më tej, theksojnë se "*mandati i deputetit z. Etem Arifi është kundërkushtetues dhe i kundërligjshëm me pasoja kushtetuese, mos përmbushja e kritereve kushtetuese për zgjedhjen e Qeverisë sipas nenit 95 par. 3 të Kushtetutës. Me fjalë tjera, vota e deputetit në fjalë në seancën e jashtëzakonshme plenare te Kuvendit, e cila sipas parashtruesve ishte përcaktuese në formimin e Qeverise, është e pavlefshme dhe, si e tillë, e bën kundërkushtetues ne aspektin procedural Vendimin Nr.07-V- 014 të datës 03.06.2020 të Kuvendit*".

76. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata si në vijim:

"I. Të shpallë të PRANUESHME këtë Kërkesë
II. Të shpallë Vendimin Nr.07-V- 014 të datës 03.06.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës në KUNDËRSHTIM me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në aspektin procedural;

III. Të urdhërojë që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 te Ligjit, të shpallet ne Gazetën Zyrtare
IV. Ky aktgjykim të hyjë në fuqi menjëherë."

Përgjigja e Sekretarisë së Kuvendit për praktika të mëhershme në Kuvend në rastet e ngjashme

77. Gjykata rikujton se ajo kërkoi nga Sekretaria e Kuvendit që të informojë Gjykatën për praktikat e mëhershme në Kuvend, lidhur me mbarimin ose pavlefshmërinë e mandatit të deputetëve të dënuar për vepra penale.

78. Lidhur me pyetjen e shtruar nga Gjykata, Sekretaria e Kuvendit e njoftoi Gjykatën se Kuvendi kishte pasur vetëm një rast gjatë Legjislaturës së V-të të Kuvendit, me deputetin Rr.M. Në atë rast, procedura e ndjekur ishte si në vijim:

"Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më 28 janar 2016, e ka njoftuar Kryetarin e Kuvendit me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë për dënimin e deputetëve, [L.G] dhe [Rr.M] (deputeti, [L.G], me 1 dhjetor 2015, ka dhënë dorëheqje nga mandati i deputetit).

Kryetari i Kuvendit, më 29 janar 2016, bazuar në nenin 112.3 te Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës që të bën zëvendësimin e deputetit, [Rr.M], nga Subjekti Politik "Koalicioni PDK-PD-LB-PSHDK dhe PKK", të cilit i ka mbaruar mandati i deputetit në pajtim me nenin 70, paragrafi 3, pika (6) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me një anëtar tjetër nga lista e kandidatëve të Subjektit Politik "Koalicioni PDK-PD-LB-PSHDK dhe PKK"- në zgjedhjet e mbajtura me 8 qershor 2014.

Presidenti i Republikës së Kosovës, më 12 shkurt 2016, e njofton Kryetarin e Kuvendit me Vendimin, datë 11 shkurt 2016, për zëvendësimin e deputetit, [Rr.M].

Në këtë rast nuk ka pasur rol Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullores së Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit [...]."

Përgjigja e KQZ-së në pyetjet e parashtruara nga Gjykata

79. Gjykata rikujton se ajo kërkoi nga KQZ që ta informoj Gjykatën lidhur me:

a) procedurën që ndiqet në KQZ për certifikimin e kandidateve/listës së kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhjet e përgjithshme, sidomos në ndërlidhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 29.1 (q) te Ligjit nr. 03/1-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës; dhe

b) nëse ekziston ndonjë procedurë apo veprim i veçantë që ndërmerr KQZ për të parandaluar që personave të dënuar për vepra penale me vendim përfundimtar të gjykatës, në tri vitet e fundit, të mos iu mundësohet të kandidohen dhe zgjidhen deputet të Kuvendit te Republikës se Kosovës, si dhe kërkoi nga KQZ që ta informoj Gjykatë nëse ka pasur raste të tilla në të kaluarën.

80. Lidhur me pyetjet e cekura më sipër, KQZ fillimisht theksoi se ajo zbaton legjislacionin zgjedhor që rregullon çështjet lidhur me: aplikimin për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve, procedurat për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, arsyet e refuzimit të kërkesës për certifikim, ankesat e aplikuesve për certifikim, shqyrtimin e aplikacioneve, tërheqjen apo zëvendësimin e kandidatëve të subjekteve politike, ruajtjen dhe verifikimin e të dhënëve të tyre, pagesën e certifikimit dhe renditjen në fletëvotime.

81. Në këtë aspekt, KQZ sqaroi se Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikimet (në tekstin e mëtejmë: ZRPPC), që vepron në kuadër të KQZ-së, ndihmon KQZ-në në pranimin, shqyrtimin teknik dhe rekomandimin për certifikim të subjekteve politike. Lidhur me këtë, KQZ theksoi se brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga shpallja e datës së zgjedhjeve nga Presidenti, partia politike e regjistruar e cila nuk dëshiron të certifikohet për zgjedhje duhet të njoftojë ZRPPC/KQZ-në që nuk garon në zgjedhje, apo që partia politike do të kërkojë certifikimin përmes koalicionit zgjedhor. Subjekti politik që synon të garojë në zgjedhje duhet të aplikoj për certifikim në KQZ brenda afatit të caktuar. Secili aplikim për certifikim të subjektit politik duhet të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar lidhur me subjektin politik. KQZ shtoi se ZRPPC, pasi shqyrton të gjitha aplikimet për certifikim dhe nëse përcakton se subjekti politik ka plotësuar të gjitha kërkesat, i bën rekomandim me shkrim KQZ-së për ta miratuar aplikimin.

82. Sa i përket aplikimit të kandidatëve për certifikim, sipas KQZ-së, subjektet politike që kanë aplikuar për certifikim për të marrë pjesë në zgjedhje duhet t'i dorëzojnë ZRPPC-së listën e kandidatëve sipas formularit të caktuar. Secili kandidat duhet të plotësojë formularin e certifikimit të kandidatit dhe me nënshkrimin e vet të konfirmoj se nuk mban asnjë post që do t'ia bënte atij të pamundur për t'u paraqitur si kandidat, bazuar në nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet, si dhe jep pëlqimin të paraqitet si kandidat për subjektin politik në listën e të cilit ai/ajo paraqitet dhe zotohet të veprojë në përputhje me ligjet zgjedhore, rregullat e zgjedhjeve të KQZ-së dhe Kodin e Sjellës.

83. Sipas KQZ-së, ZRPPC gjatë shqyrtimit të aplikacioneve shqyrton dokumentacionin e secilit kandidat se a është i plotë, si dhe, mes tjerash, a përmbushen të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Sipas tyre, *"Në ndërlidhje me pikën (q) të nenit 29 të Ligjit [...] për Zgjedhjet e Përgjithshme [...], krahasohet me listat që pranohen nga KGJK apo gjyqësori apo kurdo kur ka qenë e mundshme, Lista e Kandidatëve i është dërguar Gjyqësorit përmes KGJK-së, për të marrë konfirmim që ndonjë kandidat ka qenë i dënuar për vepër penale në tri vitet e fundit. Në zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe parakohshme, për shkak të afateve të ngjeshura, shumë rrallë është arritur të kryhet siç duhet ky verifikim."* KQZ thekson se, për zgjedhjet e rregullta, verifikimi është bërë deri në zgjedhjet e vitit 2013, ndërsa nga viti 2017, certifikimi i subjekteve politike dhe i kandidatëve të tyre është bërë në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, AA.-Uzh.nr.16/2017, të 19 shtatorit 2017.

84. Për më tepër, sa i përket pikës (q) të paragrafit 1 të nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, që përcakton se personat që paraqiten në listën e votuesve duhet të mos jenë shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit, KQZ sqaron se sipas Aktgjykimit AA.-Uzh.nr.16/2017 të Gjykatës Supreme, kjo dispozitë është interpretuar nga Gjykata Supreme ashtu që, *"askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje, nëse një e drejtë e tillë nuk i është hequr me vendim gjyqësor, e që don të thotë se kandidati duhet me vendim të formës së prerë, të shpallet fajtor dhe gjykata, t'i ketë shqiptuar dënimin plotësues "heqjen e të drejtës për tu zgjedhur"."* Andaj, KQZ thekson se *"vetëm nëse ZRPPC/KQZ do të kishte hasur në vendim gjyqësor me emërtimin "heqja e të drejtës për tu zgjedhur" do e merrte në konsideratë për të mos rekomanduar, gjegjësisht, mos certifikuar ndonjë kandidat të ndonjë subjekti politik."*

85. Duke sqaruar procedurën që i ka paraprirë Aktgjykimit të Gjykatës Supreme AA.-Uzh.nr.16/2017, të vitit 2017, KQZ sqaroi se: "*më datë 11 shtator 2017, ka marrë vendim që të decertifikohen 87 kandidat për kryetar dhe asamble komunale për zgjedhjet e 22 tetorit 2017, pjesë e këtij vendimi është edhe Z.B. kandidat për kryetar të Prizrenit [...]. Vendimi i KQZ ka ardhur si rezultatit i të dhënave nga Gjyqësori, vendimeve të formës së prerë se këta persona kanë qenë të dënuar për vepra penale. Por pas ankimimit të vendimit të KQZ-së dhe PZAP vjen Aktgjykimi Uzh.nr.16/2017 të Gjykatës Supreme [...] i cili urdhëron KQZ-në për t'u kthyer certifikimin e kandidatëve të larguar nga lista e të certifikuarave*".

86. Lidhur me Etem Arifin, KQZ në përgjigjen e vet theksoi se *"nuk ka qenë dhe nuk është e informuar që me vendim të formës së prerë i është ndaluar z. Arifi, para datës 10 shtator 2019 kur është certifikuar, që të jetë kandidat për deputet."*

87. KQZ i bashkëngjiti përgjigjes së vet edhe kërkesën për certifikim të subjektit politik PAI; formularin për certifikim të kandidatit Etem Arifi; vendimin për certifikim të subjektit politik PAI; dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A.A.-U.zh.nr.16/2017, të 19 shtatorit 2017.

Argumentet e dhëna nga palët pjesëmarrëse në seancën dëgjimore publike

88. Në seancën dëgjimore publike të 2 dhjetori 2020, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, përfaqësuesi i Kryetares së Kuvendit, përfaqësuesi i Qeverisë, Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, përfaqësuesi i KGJK-së dhe Kryetarja e KQZ-së, paraqitën argumentet dhe kundër-argumentet e tyre lidhur me rastin, si dhe u përgjigjen në pyetjet e gjyqtarëve të Gjykatës , të cilat Gjykata do t'i përmbledhë në vijim.

Argumentet e përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës

89. Përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës, gjatë prezantimit të qëndrimeve të parashtruesve në seancën dëgjimore publike, përsëriti kryesisht qëndrimet dhe argumentet të cilat janë paraqitur në kërkesën fillestare. Ai ritheksoi pretendimet dhe argumentet se vendimi i Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë është në kundërshtim me nenin 95, paragrafi 3, të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 70 paragrafi 3 pika 6, të Kushtetutës. Kjo sepse Etem Arifi, i cili ka votuar për zgjedhjen e Qeverisë, nuk ka pasur mandat të vlefshëm, si pasojë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR, nr. 328/19, të 20 gushtit 2019, përmes të cilit ai ishte dënuar me një vit e tre muaj burgim.

Prandaj, Etem Arifi e kishte humbur mandatin, në bazë të nenit 70 paragrafi 3 pika 6, të Kushtetutës.

90. Si rrjedhojë, sipas përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës, zgjedhja e Qeverisë nuk ka pasur shumicën e votave të të gjithë deputetëve, marrë parasysh faktin se vota e Etem Arifit e cila ka qenë votë përcaktuese në formimin e Qeverisë, si vota e 61-të nga numri i përgjithshëm prej 120 deputetëve, ka qenë e pavlefshme.

91. Sipas përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës, janë dy forma të kufizimeve të së drejtës për t'u zgjedhur. Kështu, papërshtatshmëria për t'u zgjedhur deputet e kufizon të drejtën pasive zgjedhore të garantuar me nenin 45 të Kushtetutës, i cili përcakton se kjo e drejtë "*mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor*". Gjithashtu, kjo e drejtë kufizohet edhe me nenin 55 të Kushtetutës, i cili përcakton se "*të drejtat dhe liritë mund të kufizohen vetëm me ligj*".

92. Përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës, tutje, theksoi se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së ky kufizim duhet të bëhet vetëm me ligj "*për të siguruar funksionimin e duhur të regjimit demokratik*". Sipas tij, Etem Arifit nuk i është mohuar e drejta për të kandiduar për deputet në zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit 2019, sipas nenit 45, paragrafi 1, të Kushtetutës, për faktin se shqiptimi i dënimit kryesor lidhur me kryerjen e veprës penale përkatëse nuk është shoqëruar me dënim plotësues [...]. Gjykata nuk ka nxjerr asnjë vendim gjyqësor plotësues në kuptim të nenit 45, paragrafi 1 të Kushtetutës, lidhur me nenin 63 të Kodit Penal dhe nenin 29 paragrafi 1, pika p të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me të cilin ja kufizon kandidimin e personit në fjalë.

93. Por, sipas përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës, Etem Arifi nuk është dashur të certifikohet si kandidat për deputet, bazuar në nenin 55 të Kushtetutës, i cili parasheh që të drejtat dhe liritë mund të kufizohen vetëm me ligj dhe, rrjedhimisht, në nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili parasheh që një person është i aftë të kandidojë si kandidat për deputet, përveç nëse është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit. Përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës theksoj se moszbatimi i nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është "*papërgjegjësi totale juridike e KQZ-së*".

94. Përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës theksoi se ushtrimi i pushtetit politik nga njerëz që shkelin seriozisht ligjin mund te rrezikojë natyrën demokratike te shtetit, duke shtuar se një person që nuk njehë standardet e sjelljes në shoqërinë demokratike, mund të mos jetë i

gatshëm t'i bindet standardeve kushtetuese ose ndërkombëtare për demokracinë dhe sundimin e ligjit. Për më tepër, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës ngriti pyetjen si është e mundur që dikush nga burgu të përfaqësojë interesat e atyre që e kanë zgjedhur.

95. Në lidhje me këtë, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës pretendoi se certifikimi i kandidatit Etem Arifi nga KQZ-ja ka ndodhur edhe për shkak se deputeti ka gënjyer me rastin e paraqitjes së formularit, kur ka theksuar se kandidatura e tij është në përputhshmëri me nenin 29, paragrafi 1 pikën (q). Kjo, sipas tij, vërtetohet edhe nga përgjigja e KQZ-së drejtuar Gjykatës, ku theksohet se kandidati nuk e ka informuar KQZ-në se ishte i dënuar nga një gjykatë me vendim të formës së prerë, me dënimin me burgim mbi një vit. Sipas tij, as KGJK-ja nuk e ka njoftuar KQZ-në dhe as ndonjë institucion tjetër për faktin se Etem Arifi kishte një vendim të formës së prerë, përmes të cilit ishte dënuar me një vit e tre muaj burgim.

96. Përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës gjithashtu iu referua edhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, AA.-Uzh.nr.16/2017, sipas të cilit e drejta për t'u zgjedhur mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor plotësues. Sipas tij, Gjykata Supreme pa asnjë bazë ligjore është kthyer në nenin 45 të Kushtetues, duke e shpallur, në njëfar mënyre, kundërkushtetues nenin 29, paragrafin 1 pika q, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – gjë e cila nuk është në kompetencë të kësaj gjykate.

97. Më tutje, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës theksoi se Kuvendi deri më 4 maj 2020 nuk ka qenë i njoftuar se deputeti ne fjalë është dënuar me vendim të formës së prerë. Kësisoj, sipas parimit të standardit juridik të përgjithshëm, efektet e vendimit fillojnë të prodhojnë pasoja juridike në momentin që pala, në këtë rast Kuvendi, është njohur me pasojat e këtij vendim. Në rastin konkret kjo do të thotë më 4 maj 2020, pra, gjatë legjislaturës aktuale.

98. Përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës ka argumentuar se Dekreti i Presidentit për emërimin e z. Avdullah Hoti si kandidat për Kryeministër nuk ka efekt juridik, duke qenë se procedura për zgjedhjen e Qeverisë, në seancën e Kuvendit të 3 qershorit 2020, është ezauruar. Sipas përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës, pasi që Dekreti i Presidentit për emërimin e z. Avdullah Hoti si kandidat për Kryeministër nuk ka efekt juridik, Gjykata Kushtetuese duhet të shpallë vendimin e kontestuar si jokushtetues dhe duhet të vendosë që të shkohet në zgjedhje, *"ose situata të kthehet në pikën zero"*, për sa i përket zgjedhjes së Qeverisë, sipas paragrafit 2 të nenit 95 të Kushtetutës.

Argumentet e përfaqësuesit të Kryetares së Kuvendit

99. Përfaqësuesi i Kryetares së Kuvendit mbajti qëndrimin se Kryetarja e Kuvendit është njoftuar për dënimin e Etem Arifit fillimisht nga mediat dhe menjëherë ka kërkuar nga KGJK dhe Gjykata e Apelit që të dorëzojnë në Kuvend vendimet gjyqësore lidhur me rastin në fjalë.

100. Ai theksoi se pas pranimit të vendimeve gjyqësore nga KGJK, drejtuar Kryetares së Kuvendit, më 4 maj 2020, Kryetarja e Kuvendit i është drejtuar Komisionit për Mandate dhe Imunitete të Kuvendit për të kërkuar sqarime lidhur me statusin e Etem Arifit në legjislaturën aktuale. Ky Komision nuk ka dhënë një përgjigje specifike lidhur me çështjen në fjalë. Në ndërkohë Kuvendi përmes vendimit të kontestuar ka zgjedhur Qeverinë e re, me ç'rast parashtruesit e kërkesës i ishin drejtuar Gjykatës duke kërkuar që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar, ku objekt shqyrtimi ishte edhe vlefshmëria e mandatit të Etem Arifit.

101. Në sqarimin e mëtutjeshëm, përfaqësuesit i Kryetares së Kuvendit deklaroi se Kryetarja e Kuvendit duke qenë në dijeni që parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar në Gjykatën Kushtetuese, nuk kishte ndërmarrë veprime të tjera, duke përfshirë zëvendësimin e deputetit në fjalë sipas legjislacionit në fuqi. Përfaqësuesi i Kryetares së Kuvendit, gjithashtu, konfirmoi se Etem Arifi është ende në listën e deputetëve të Kuvendit të legjislaturës aktuale.

Argumentet e përfaqësuesit të Komisionit për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete

102. Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, gjatë paraqitjes së tij, njoftoi Gjykatën se qëndrimet e këtij Komisioni janë që asnjë dispozitë e Rregullores së Kuvendit nuk flet për rastet kur deputeti e humb mandatin *Ipso jure*, përveç në rastin siç përcaktohet me nenin 70, paragrafi 3, nënparagrafi 5 i Kushtetutës, dhe nenin 25 paragrafi 1 pika e) e Rregullores së Kuvendit. Sipas tij, Komisioni përkatës për Legjislacion, shqyrton çështjen e mandatit të deputetit vetëm në rastet siç përcaktohet me nenin 25 paragrafi 1, pika e) të Rregullores së Kuvendit, kur një deputet mungon gjashtë (6) muaj rresht në seancat e Kuvendit. Andaj, ky Komision nuk ka obligime

ligjore që të ndërmerr veprime në rastet kur një deputet humb mandatin si rezultat i kryerjes së një vepre penale.

Argumentet e përfaqësuesit të Qeverisë

103. Përfaqësuesi i Qeverisë mbajti qëndrimin se kërkesa e parashtruesve të kërkesës duhet të shpallet nga Gjykata si kërkesë e papranueshme, "*mbi frymën e papërshtatshmërisë së saj formale , të cilat do t'i lejojnë Gjykatës Kushtetuese që ta shpallë si të papranueshme kërkesën në fjalë*".

104. Përfaqësuesi i Qeverisë, duke u thirrur në Opinionin e Komisionit të Venecias, të datës 23 nëntor 2018, "*lidhur me përjashtimin e shkelësve të ligjit nga parlamenti*", theksoi se lidhur me kufizimin e të drejtave zgjedhore "*duhet të ndiqet një kufizim legjitim, i cili të jetë i domosdoshëm në një shoqëri demokratike, ndërsa mjetet kufizuese dhe vete kufizimi duhet te jenë proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet*". Sipas përfaqësuesit të Qeverisë, pavlefshmëria e mandatit nga neni 70. 3 (6), si dhe pamundësia e kandidimit nga neni 73.2 i Kushtetutës, në të cilat thirren parashtruesit e kërkesës, janë dy gjera tërësisht te ndryshme dhe nuk ndërlidhen me kufizimin e të drejtave zgjedhore, nga neni 45 i Kushtetutës.

105. Ai gjatë argumentimit të qëndrimit të Qeverisë shtoi se thelbi i problemit kushtetues në rastin konkret nuk është nëse Etem Arifi ka humbur apo nuk ka humbur mandatin e vet si deputet në legjislaturën e gjashtë, por nëse ai ka pasur kufizime gjyqësore ndaj realizimit të të drejtave të tij kushtetuese, nga neni 45 i Kushtetutës, për kandidim në legjislaturën e shtatë.

106. Përfaqësuesi i Qeverisë, lidhur me faktin nëse Etem Arifi ka pasur kufizime të të drejtave të tij kushtetuese konform nenit 45 të Kushtetutës, theksoi se "*neni 73.2 i Kushtetutës flet për rastin e pamundësisë se kandidimit dhe jo për kufizimin e ndonjë të drejte kushtetuese sipas nenit 45 të Kushtetutës. Ne nenin 73.3 te Kushtetutës kjo pamundësi ka të bëjë me rastet kur një person ka probleme me zotësinë e veprimit*".

107. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se humbja e mandatit të deputetit prodhon momente kushtetuese, kur një deputet dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, me dënim me burgim një vit e më shume, përfaqësuesi i Qeverisë argumentoi se nëse ndiqet një qasje e tillë "*atëherë do të krijohej pasiguri totale juridike, në të cilën nuk do te vlente asnjë garanci kushtetuese, ndërsa ndjekja e një*

logjike të tillë do të nënkuptonte qe instituti juridik i rehabilitimit në një shoqëri demokratike do te zhvishej nga çdo përmbajtje".

108. Përfaqësuesi i Qeverisë mbajti qëndrimin se Etem Arifi ka humbur mandatin e tij si deputet kur është dënuar me Aktgjykimit PAKR.nr.328/2018, të Gjykatës së Apelit, të 28 marsit 2019, dhe, sipas tij, një deputet e humb mandatin vetëm një herë. Në rastin konkret Etem Arifi e kishte humbur mandatin kur për herë të parë ishte dënuar me Aktgjykimin e lartcekur dhe që kishte të bënte me legjislaturën e kaluar dhe jo më legjislaturë aktuale.

109. Gjithashtu, sipas përfaqësuesit të Qeverisë, nëse Gjykata vlerëson se Etem Arifi nuk ka pasur mandat të vlefshëm, atëherë ai mban qëndrimin se Qeveria është zgjedhur me numër të mjaftueshëm të votave, marrë parasysh faktin se pasi që mandati i Etem Arifit ka qenë i pavlefshme, atëherë Kuvendi ka pasur gjithsej 119 deputet me mandat të vlefshëm. Rrjedhimisht, sipas tij, vendimi i kontestuar ka marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit që kanë pasur mandat të vlefshëm, respektivisht 60 vota.

Argumentet e përfaqësuesit të KGJK-së

110. Përfaqësuesi i KGJK-së sqaroi se KGJK nuk ka asnjë detyrim ligjor specifik që të njoftojë institucionet e Republikës së Kosovës në rast se ndonjë deputet i Kuvendit dënohet me vendim të formës së prerë.

111. Ai më tutje sqaroi se, megjithëse nuk ekziston një detyrim ligjor, KGJK vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të palëve, ashtu siç ka vepruar edhe në rastin konkret pas kërkesës së 30 prillit 2020 të Kryetares së Kuvendit, ku KGJK ka dorëzuar në Kuvend kopjet e aktgjykimeve me të cilat Etem Arifi ishte shpallur fajtor për vepër penale, duke përfshirë Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR 328/19, të 20 gushtit 2019 dhe Aktgjykimin PML. Nr. 380/20, të Gjykatës Supreme, të 30 janarit 2020. Më tej, ai shtoi se KGJK vazhdimisht ka ofruar informata të tilla kur kësaj të fundit i është kërkuar nga KQZ, ose nga institucione të tjera.

Argumentet e Kryetares së KQZ-së

112. Kryetarja e KQZ-së theksoi se KQZ zbaton legjislacionin zgjedhor që rregullon çështjet lidhur me aplikimin për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve, procedurat për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, arsyet e refuzimit të kërkesës për certifikim, ankesat e aplikuesve për certifikim, shqyrtimin e

aplikacioneve, si dhe tërheqjen apo zëvendësimin e kandidatëve të subjekteve politike.

113. Sa i përket pikës (q) të paragrafit 1 të nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, që përcakton se personat që paraqiten në listën e votuesve duhet të mos jenë shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit, Kryetarja e KQZ-së sqaroi se sipas Aktgjykimit AA.-Uzh.nr.16/2017 të Gjykatës Supreme, kjo dispozitë është interpretuar nga Gjykata Supreme ashtu që askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje nëse një e drejtë e tillë nuk i është hequr me vendim gjyqësor, e që do të thotë se kandidati duhet me vendim të formës së prerë të shpallet fajtor dhe gjykata t'i ketë shqiptuar dënimin plotësues "*heqjen e të drejtës për tu zgjedhur*". Andaj, Kryetarja e KQZ-së sqaroi se vetëm nëse KQZ-ja do të kishte hasur në vendim gjyqësor për "*heqjen e të drejtës për tu zgjedhur*" do e merrte në konsideratë për të mos rekomanduar, gjegjësisht mos certifikuar ndonjë kandidat të ndonjë subjekti politik.

114. Lidhur me Vendimin e lartcekur të Gjykatës Supreme, Kryetarja e KQZ-së theksoi se i njëjti është i debatueshëm dhe me të cilin ajo personalisht nuk pajtohet.

115. Kryetarja e KQZ-së, më tej, sqaroi para Gjykatës se, pas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme AA..Uzh.nr.16/2017, KQZ-ja kishte lejuar certifikimin e 87 kandidatëve, të cilët më parë ishin decertifikuar nga KQZ-ja (pasi që kjo e fundit kishte marrë informata nga KGJK-ja se kandidatët ishin të dënuar për vepra penale gjatë tri viteve të fundit).

116. Lidhur me Etem Arifin, Kryetarja e KQZ-së informoi se në aplikacionin e paraqitur dhe të nënshkruar nga Etem Arifi, ai zotohej se plotësonte të gjitha kushtet për tu kandiduar për deputet dhe se ai askund nuk kishte theksuar se ishte i dënuar për vepër penale

Dispozitat e rëndësishme të Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

[...]

Neni 64 [Struktura e Kuvendit]

1. Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.

Neni 70 [Mandati i Deputetëve]

1. *Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues.*
2. *Mandati i deputetit të Kuvendit të Kosovës fillon ditën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjes.*
3. *Mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm, nëse:*
   (1) nuk bën betimin;
   (2) jep dorëheqjen;
   (3) emërohet anëtar i Qeverisë së Kosovës;
   (4) përfundon mandati i Kuvendit;
   (5) mungon gjashtë (6) muaj rresht në seancat e Kuvendit. Në raste të veçanta, Kuvendi i Kosovës mund të vendosë ndryshe;
   (6) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale me një ose më shumë vjet burgim;
   (7) ajo/ai vdes.

4. Vendet e liruara të deputetëve në Kuvend, plotësohen menjëherë, në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligjin.
[...]

Neni 71 [Kualifikimet dhe Barazia Gjinore]

1. Secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë (18) vjeç ose më i madh dhe përmbush kriteret ligjore, mund të jetë kandidat për deputet.
2. Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektoj parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuara në pajtim me parimet ndërkombëtare.

Neni 72 [Papajtueshmëria]

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nuk mund të mbajë ndonjë post ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike, dhe as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër ekzekutiv, sikurse është përcaktuar me ligj.

Neni 73 [Pamundësia e Kandidimit]

1. *Nuk mund të kandidohen dhe as të zgjidhen deputetë të Kuvendit, pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre:*

   (1) gjyqtarët dhe prokurorët;
   (2) pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës;
   (3) pjesëtarët e Policisë së Kosovës;
   (4) pjesëtarët e Doganave të Kosovës;
   (5) pjesëtarët e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
   (6) udhëheqësit e agjencive të pavarura;
   (7) përfaqësuesit diplomatikë;
   (8) kryetarët dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Nuk mund të kandidohen për deputetë personat e privuar nga zotësia juridike për të vepruar, me vendim përfundimtar të gjykatës.
3. Kryetarët dhe zyrtarët e tjerë, të cilët mbajnë përgjegjësi ekzekutive në nivel komune, nuk mund të zgjidhen si deputetë të Kuvendit pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre.

Neni 74 [Ushtrimi i Funksionit]

Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.
[...]

Neni 75 [Imuniteti]

1. Deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet e tyre brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit. Imuniteti nuk pengon ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive së tyre si deputetë të Kuvendit.
2. Deputeti i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as ndalohet përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit, pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Neni 95 [Zgjedhja e Qeverisë]

1. Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.
2. Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.
3. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.
4. Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.
5. Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.
6. Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj.

Ligji nr. 03/l-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës
(i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256)

Neni 29
Përshtatshmëria/Aftësia e Kandidatit

29.1 Cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve është i aftë për certifikim si kandidat përveç nëse ai apo ajo është:

a) gjykatës apo prokuror në Kosovë ose gjetkë;
b) pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës;
c) pjesëtar i Policisë së Kosovës;
d) pjesëtar i Shërbimit Doganor të Kosovës;
e) pjesëtar i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
f) kryesues i një agjencie të pavarur;
g) përfaqësues diplomatik;
h) kryesues apo anëtar i KQZ-së;
i) pjesëtar i PZAP-it;

j) anëtar i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve;
k) pjesëtar i forcave të armatosura të ndonjë shteti;
l) pjesëtar i ndonjë force policore apo të një trupi të ngjashëm;
m) duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë;
n) nën akuzë nga Tribunali dhe ka dështuar të veprojë në përputhje me urdhrin për t'u paraqitur para Tribunalit;
o) me anë të vendimit të gjykatës, përfshirë edhe vendimin e PZAP-it i është hequr e drejta për të qenë kandidat;
p) me anë të vendimit të gjykatës, i është hequr e drejta për të qenë kandidat;
q) i shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit;
r) ka dështuar të paguajë gjobën e vënë nga PZAP-i apo KQZ-ja; ose
s) ka dështuar t'i përmbahet ndonjë urdhri të PZAP-it.
[...]

29.4 Nëse kandidati i cili është certifikuar nga KQZ-ja është apo ka arritur statusin sipas të cilit ai apo ajo humb aftësinë për të qenë kandidat sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, ai person decertifikohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe largohet nga lista e kandidatëve të subjektit politik në fjalë.

Neni 112
Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendit

112.1 Vendet e shpërndara ne përputhje me këtë Ligj mbahen personalisht nga kandidatet e zgjedhur dhe jo nga subjekti politik. Mandati i anëtarit nuk do të ndryshohet apo ndërpritet para se të përfundoj mandati përveç ne rastet vijuese:

a) dënimi i anëtarit për vepër penale për të cilën ai apo ajo është dënuar me burgim sikurse parashikohet me anë të nenit 69.3 (6) [70.3 (6)] *të Kushtetutës;*
b) dështimi i anëtarit që të marrë pjesë në seancat e Kuvendit apo të Komiteteve për gjashtë (6) muaj radhazi, anëtar i të cilave ai apo ajo janë, përveç nëse jepet ndonjë arsye bindëse në pajtim me Rregullat e Kuvendit;
c) humbja e mandatit të anëtarit, sipas nenit 29 të këtij ligji;
[...]

112.2 Një anëtar i Kuvendit të Kosovës mandati i të cilit përfundon në pajtim me nenin 112.1 zëvendësohet si vijon:

a) nga kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini i cili ka fituar numrin më të madh të votave të listës së riorganizuar të kandidatëve të Subjektit Politik në emër të së cilës garoi anëtari;
b) nëse nuk ka ndonjë kandidat tjetër të ligjshëm me gjini të njëjtë nga lista e kandidatëve, nga kandidati i radhës i cili ka fituar numrin më të lartë të votave në listën e kandidatëve;
c) nëse nuk ka kandidat tjerë të ligjshëm në listën e kandidatëve, shkon kandidati i ardhshëm legjitim nga lista e kandidatëve të etnitetit politik që ka pasur koeficientin më të madh të votave sipas formulës së përcaktuar në nenin 111.4 të këtij ligji nga zgjedhjet e fundit të të njëjtit lloj; dhe
d) nëse anëtari është kandidat i pavarur, shkon kandidati i ardhshëm legjitim nga lista e kandidatëve të etnitetit politik që ka pasur koeficientin më të madh të votave sipas formulës së përcaktuar në nenin 111.4 të këtij ligji.

112.3 Pasi që një ulëse të mbetet e zbrazët, Kryetari i Kuvendit i bën kërkesë me shkrim Presidentit për mbushjen e ulëses së zbrazët. Një kërkesë e tillë duhet të përfshij edhe sqarimin se pse u lirua kjo ulëse.
112.4 Pas pranimit të kërkesës sipas paragrafit 3 të këtij neni, nëse sqarimi i dhënë është i mjaftueshëm, Presidenti duhet të kërkojë nga KQZ-ja të rekomandojë emrin e personit për ta mbushur vendin e lirë. KQZ-ja duhet që në afatin prej pesë (5) ditëve të punës nga momenti i marrjes së kërkesës, t'ia ofrojë Presidentit emrin [e] radhës së personit të ligjshëm sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Ligji nr. 03/l-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit

Neni 5
Mandati i deputetit

[...]
2. Mandati i deputetit fillon që nga momenti i certifikimit të mandatit nga ana e autoritetit kompetent në përputhje me ligjin. Mandati i deputetëve të përbërjes paraprake të Kuvendit përfundon po të njëjtën ditë.
[...]

Neni 8

Përfundimi i Mandatit

1. Mandati i Deputetit/es përfundon para kohe:
[...]

1.6. nëse me vendimin e formës së prerë të gjykatës dënohet për vepër penale me vuajtje të dënimit për një ose më shumë vjet burg;

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës

"Neni 9
Kryesimi i mbledhjes konstituive të legjislaturës së Kuvendit
[...]

3. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të legjislaturës së Kuvendit, pas hapjes së mbledhjes dhe paraqitjes së rendit të ditës, kërkon nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvend ta caktojnë nga një përfaqësues në Komisionin e përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve.
4. Komisioni i përkohshëm e shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve, ia paraqet Kuvendit raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit dhe e verifikon kuorumin në mbledhjen konstituive të legjislaturës së Kuvendit.

Neni 22
Imuniteti i deputetit të Kuvendit

1. Deputeti gëzon imunitet, në pajtim me Kushtetutën.
[...]
4. Imuniteti i deputetit fillon në ditën e verifikimit të mandatit dhe mbaron me përfundimin e mandatit të tij.
5. Kuvendi, përjashtimisht nga paragrafi 4 i këtij neni, mund t'ia heqë imunitetin deputetit para mbarimit të mandatit.
6. Kërkesën për heqjen e imunitetit të deputetit e bën organi kompetent për ndjekje penale. Vendimin për heqjen e imunitetit të deputetit e merr Kuvendi, në përputhje me rekomandimet e Komisionit për Mandat, Imunitet dhe Rregullore.
7. Masa e ndalesës ose e arrestit mund të merret ndaj deputetit edhe pa heqjen paraprake të imunitetit nga Kuvendi, në rastin kur deputeti kryen vepër të rëndë penale, që është e dënueshme me pesë (5) e më shumë vjet burgim.

Neni 23
Procedura e heqjes së imunitetit

1. Kërkesën për heqjen e imunitetit të deputetit, bashkë me dokumentet e tjera përcjellëse, organi kompetent i ndjekjes penale ia parashtron Kryetarit të Kuvendit. Kërkesën e organit të ndjekjes, së bashku me dokumentet përcjellëse, Kryetari, brenda 48 orëve, ia dërgon Komisionit për Mandat, Imunitet dhe Rregullore.
2. Komisioni për Mandat, Imunitet dhe Rregullore, brenda 30 ditësh, pas marrjes së kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni, e shqyrton kërkesën dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime.
3. Komisioni e njofton deputetin, imuniteti i të cilit kërkohet të hiqet, për kërkesën dhe për kohën e shqyrtimit të saj në komision.
4. Deputeti ftohet të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit dhe në mbledhje plenare për t'i dhënë shpjegimet dhe vërejtjet rreth çështjes.
5. Mospjesëmarrja e deputetit të ftuar në mbledhje nuk e pengon Komisionin dhe Kuvendin të vendosin edhe pa praninë e tij.
6. Kuvendi e shqyrton raportin me rekomandimet e Komisionit më së voni në mbledhjen e dytë të radhës. Në fillim të shqyrtimit të çështjes, fjala i jepet deputetit për të dhënë shpjegime dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve.
7. Për heqjen e imunitetit të deputetit Kuvendi vendos me vota të fshehta të shumicës së deputetëve të Kuvendit.
[...]

Neni 25
Humbja e statusit të deputetit të Kuvendit

1. Deputeti i Kuvendit e humb mandatin, nëse:

a) nuk e bën betimin,
b) jep dorëheqje,
c) përfundon mandati i Kuvendit,
d) dënohet për një vepër penale me burgim për një periudhë kohore prej një (1) e më shumë vjet,
e) në periudhën gjashtëmujore nuk merr pjesë në asnjë mbledhje të Kuvendit. Nëse deputeti nuk ia dëshmon faktet bindëse për çështjen Kryetarit të Kuvendit, Kryetari e kërkon rekomandimin e Komisionit për Mandat, Imunitet dhe Rregullore. Pas rekomandimit të Komisionit Kryetari ia

propozon Kuvendit pushimin e funksionit të deputetit. Kuvendi vendos për çështjen në mbledhje të radhës;
f) me vendim të formës së prerë të gjykatës nëse është konstatuar mungesa e aftësisë së tij juridike për të vepruar,
g) vdes.

2. Për rastet nga pika 1. e) e këtij neni, deputeti mund t'ia paraqesë Kuvendit me shkrim argumentet për t'i treguar arsyet bindëse për mospjesëmarrje në mbledhje dhe i lejohet t'i drejtohet Kuvendit, nëse dëshiron.

3. Vendet e liruara të deputetëve, në çfarëdo rasti që përcaktohen me këtë rregull, plotësohen në përputhje me nenin 70.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 112 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

[...]

SHTOJCA Nr.2 e Rregullores së Kuvendit

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (Sipas Vendimi të Kuvendit 07-V-008 i datës 13.2.2020)

Fushëveprimi i këtij Komisioni përfshin:

" [...]
- Interpretimin e Rregullores së Kuvendit, kur kërkohet nga Kuvendi;
- Shqyrtimin e kërkesave për heqjen e Imunitetit dhe të Mandatit të deputetëve dhe ia paraqet rekomandimet Kuvendit;
[...]"

Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës

"DËNIMET PLOTËSUESE

Neni 62
Dënimet plotësuese

1. Dënimi plotësues mund të shqiptohet së bashku me dënimin kryesor ose alternativ.

2. Dënimet plotësuese janë:

2.1 heqja e të drejtës për t'u zgjedhur;

[...]

Neni 63
Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur

Gjykata ia heq kryesit të veprës penale të drejtën për tu zgjedhur prej një (1) deri në katër (4) vjet, nëse ai person, me qëllim që të zgjidhet, kryen ndonjë nga veprat penale kundër të drejtave të votimit ose vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku dy (2) vjet burgim."

Neni 336
Mashtrimi me subvencione

1. Kushdo që në lidhje me aplikimin për marrjen, vazhdimin ose modifikimin e kushteve për marrjen e një subvencioni, i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta apo jo të plota, e që është kusht për aprovimin, vazhdimin apo modifikimin e subvencionit, ose fsheh të dhënat e tilla në kundërshtim me detyrimin për të zbuluar të dhënat e tilla organit kompetent, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që përdor subvencionin e tillë në shkelje të ligjit ose për tjera qëllime nga ato për të cilat është dhënë subvencioni nga dhënësi i subvencionit, dënohet me gjobe ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton në dobi pasurore ose në dëm pasuror që tejkalon shumën prej njëzetepesëmijë (25.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

[...]

Kodit Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale

Neni 407
Ankesa në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit

1. Ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit mund të paraqitet në Gjykatën Supreme të Kosovës në rastin kur Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin ose kur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ose Gjykatës së Apelit i është shqiptuar dënimi me burg të përjetshëm.

Neni 485
Forma e prerë dhe ekzekutueshmëria e vendimit

1. Aktgjykimi merr formë të prerë kur më nuk mund të kundërshtohet me ankesë ose kur nuk lejohet ankesë.
2. Aktgjykimi i formës së prerë ekzekutohet kur është bërë dorëzimi dhe kur për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore. Në qoftë se nuk është parashtruar ankesë ose palët kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë apo janë tërhequr nga ankesa e parashtruar, aktgjykimi konsiderohet i ekzekutueshëm pas kalimit të afatit për ankesë apo nga dita e heqjes dorë ose e tërheqjes së ankesës.
[...]

Pranueshmëria e kërkesës

117. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj e me Rregullore të punës.

118. Në këtë vazhdë, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

119. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet nenit 113.5 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur".

120. Gjykata konstaton se kërkesa është paraqitur nga 17 (shtatëmbëdhjetë) deputetë të Kuvendit, në pajtueshmëri me nenin 113.5 të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar për të paraqitur këtë kërkesë.

121. Në vijim, Gjykata merr parasysh nenin 42 [Saktësimi i kërkesës], të Ligjit, i cili përcakton se kërkesa e paraqitur sipas nenit 113.5 të Kushtetutës duhet të përmbajë:

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;
1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe
1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti".

122. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit], të Rregullores së punës, që parasheh:

"[...]

(2) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:
(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose të një vendimi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
(b) dispozitat e Kushtetutës ose të aktit tjetër ose legjislacionit relevant për këtë kërkesë; dhe
(c) provat mbi të cilat mbështetet kontesti.
(3) Parashtruesit i bashkëngjisin kërkesës një kopje të ligjit të kontestuar ose vendimit të miratuar nga Kuvendi, regjistrin dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën dhe autorizimin e personit që i përfaqëson ata para Gjykatës".

123. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës shënuan emrat e deputetëve dhe nënshkrimet e tyre; paraqitën autorizimin për personin që i përfaqëson ata para Gjykatës; specifikuan vendimin që kontestojnë dhe dorëzuan kopjen e tij; iu referuan dispozitave specifike kushtetuese, me të cilat ata pretendojnë se vendimi i kontestuar nuk është në pajtueshmëri; si dhe paraqitën prova dhe dëshmi për të mbështetur pretendimet e tyre. Andaj, Gjykata konsideron se kriteret e përcaktuara me nenin 42 të Ligjit dhe të specifikuara më tej me rregullin 74 të Rregullores së punës janë plotësuar.

124. Për sa i përket afatit të përcaktuar për të paraqitur kërkesën, që është 8 (tetë) ditë nga data e miratimit të aktit të kontestuar, Gjykata vëren se vendimi i kontestuar është miratuar më 3 qershor 2020, ndërsa kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 11 qershor 2020.

125. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që, në pajtim me rregullin 30 (1) të Rregullores së punës, afati i fundit për dorëzimin e kërkesës, "*kur periudha shprehet me ditë, ajo duhet të llogaritet duke filluar nga dita pasuese pasi kishte ndodhur një ngjarje*".

126. Në rastin e kërkesës së tanishme, kjo është dita e nesërme pas miratimit të vendimit të kontestuar. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa u parashtrua brenda afatit kohor të përcaktuar me nenin 113. 5 të Kushtetutës.

127. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesit kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj e me Rregullore të punës.

128. Prandaj, Gjykata e shpallë kërkesën të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

Meritat e kërkesës

129. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesit e kërkesës kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, duke pretenduar se ky i fundit është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë], në lidhje me nënparagrafin 6 të paragrafit 3 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve], të Kushtetutës.

130. Gjykata thekson se çështja kushtetuese që ngritin parashtruesit në kërkesën e tyre ndërlidhet me përputhshmërinë me Kushtetutën të vendimit të kontestuar, përmes të cilit Kuvendi, më 3 qershor 2020, kishte zgjedhur Qeverinë. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se procedura e ndjekur nga Kuvendi për zgjedhjen e Qeverisë ishte në kundërshtim me paragrafin 3 të nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë], të Kushtetutës, i cila parash se "*Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit*" e që, bazuar në nenin 64 [Struktura e Kuvendit] ku parashihet se Kuvendi i Kosovë i ka 120 deputetë, nënkupton që për të zgjedhur Qeverinë nevojitet që 61 deputetë të Kuvendit të votojnë "për" zgjedhjen e Qeverisë. Sipas parashtrueseve, kjo shkelje ka ndodhur sepse gjatë procedurës për nxjerrjen e vendimit të kontestuar, Kuvendi ka vepruar në kundërshtim me nenin 70 [Mandati i Deputetëve], paragrafi 3, nënparagrafi 6.

131. Në këtë sfond, argumentin e tyre parashtruesit e kërkesës e ndërtojnë duke theksuar se, përkundër faktit që sipas paragrafit 3 të nenit 95 për t'u zgjedhur Qeveria, janë të nevojshme 61 vota të vlefshme të deputetëve, në votimin e zhvilluar në Kuvend për zgjedhjen e Qeverisë, më 3 qershor 2020, kanë qenë të vlefshme vetëm 60 vota të deputetëve. Kjo pasi, sipas tyre, vota e Etem Arifit është llogaritur si votë e 61-të për zgjedhjen e Qeverisë, përkundër faktit që mandati i tij si deputet nuk ka qenë i vlefshëm për arsye se ai është dënuar me

vendim të formës së prerë për vepër penale me dënim mbi një vit burgim. Sipas parashtrueseve të kërkesës, kjo do të thotë se Etem Arifi automatikisht ka humbur mandatin e tij si deputet, konform nënparagrafit 6 të paragrafit 3 të nenit 70 të Kushtetutës, që përcakton se mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm nëse ai/ajo "*dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale me një ose më shumë vjet burgim*". Lidhur me këtë, parashtruesit pretendojnë se mandati i Etem Arifit është bërë i pavlefshëm ditën kur Kuvendi është informuar se deputeti në fjalë është i dënuar për vepër penale me burgim me dënim mbi një vit.

132. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se zgjedhja e Qeverisë përmes vendimit të kontestuar, duke u miratuar edhe me votën e Etem Arifit, vota e të cilit ka qenë vendimtare, është në kundërshtim me Kushtetutën.

133. Në dritën e kësaj, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesve ngërthen dy çështje thelbësore: *së pari,* a kishte mandat të vlefshëm Etem Arifi në kohën e nxjerrjes në Kuvend të vendimit të kontestuar (në votimin e të cilit deputeti në fjalë ka marrë pjesë); *së dyti*, a është në pajtueshmëri me Kushtetutën vendim i kontestuar i Kuvendit nëse në miratimin e tij ka marrë pjesë një deputet i cili nuk ka pasur mandat të vlefshëm.

134. Në trajtimin e dy çështjeve në fjalë, Gjykata, fillimisht, do referohet në: *(i)* Qëndrimet e Komisionit të Venecias lidhur me pamundësinë (papërshtatshmërinë) për kandidim në zgjedhje parlamentare dhe humbjen e mandatit të deputetëve si rezultat i dënimit për vepra penale; *(ii)* Përgjigjet e shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias në pyetjet e dërguara nga Gjykata, lidhur me rastin konkret; *(iii)* Praktikat e deritashme të Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me mbarimin ose pavlefshmërinë e mandatit të deputetëve si rezultat i dënimeve për vepra penale.

(i) *Qëndrimet e Komisionit të Venecias lidhur me pamundësinë (papërshtatshmërinë) për kandidim në zgjedhje parlamentare dhe humbjen e mandatit të deputetëve si rezultat i dënimit për* vepra penale

135. Standardet lidhur me çështjen e kandidimit në zgjedhje parlamentare dhe humbjes/pavlefshmërisë së mandatit të deputetëve janë elaboruar në mënyrë gjithëpërfshirëse në *Raportin e Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave Penale nga Parlamenti*, miratuar nga Komisioni i Venecias në Takimin e 104-të Plenar, të 23-24 tetorit 2015, CDL-AD(2015)036 dhe shpallur përmes Opinionit Nr.

807/2015, të 23 nëntorit 2018 (në tekstin e mëtejmë: Raporti i Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave të Paligjshme nga Parlamenti).

136. Përveç kësaj, për të pasqyruar plotësisht qëndrimin e Komisionit të Venecias për çështje që lidhen me zgjedhjet parlamentare dhe humbjen/pavlefshmërinë e mandatit të deputetit, Gjykata do vë në dukje edhe elementët kryesorë të dy dokumenteve në vijim:

- *Kodi i Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore i Komisionit të Venecias* nr. CDL-AD(2002)023rev2-cor, i miratuar në Seancën Plenare të 18-19 tetorit 2002 dhe i shpallur përmes Opinionit Nr. 190/2002, të 25 tetorit 2018 (në tekstin e mëtejmë: Kodi i Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore i Komisionit të Venecias); *dhe*

- *Raporti i Komisionit të Venecias për Legjislacionin Zgjedhor dhe Administrimin e Zgjedhjeve në Evropë* nr. CDL-AD(2006)018, i 12 qershorit 2006, i miratuar në Seancën Plenare të 9-10 qershorit 2006, i Komisionit të Venecias dhe i shpallur përmes Studimit Nr. 352/2005, të 12 qershor 2006 (në tekstin e mëtejmë: Raporti i Komisionit të Venecias për Legjislacionin Zgjedhor dhe Administrimin të Zgjedhjeve në Evropë).

Raporti i Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave Penale nga Parlamenti

137. Raporti i Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave Penale nga Parlamenti bënë një analizë krahasuese, në prizmin e kufizimit të të drejtës pasive zgjedhore, gjegjësisht të të drejtës për t'u zgjedhur, të garantuar me nenin 3 të Protokollit 1 [E Drejta për zgjedhje të lira], të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tutje: KEDNJ). Në këtë vazhdë, Raporti i lartcekur i Komisionit të Venecias referohet në praktikën e pasur të GJEDNJ-së, përkitazi me pamundësinë për t'u kandiduar për anëtar parlamenti. Kështu, në praktikën e saj lidhur me kufizimin e të të drejtës pasive zgjedhore, GJEDNJ ka vënë në pah se, për të qenë në përputhje me KEDNJ, kufizimi i tillë duhet të jetë i paraparë me normë ligjore, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të jetë proporcional (shih, ndër të tjera: *Hirst kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i GJEDNJ, i 6 tetorit 2005).

138. Sidoqoftë, në rastin konkret, Gjykata sjellë në vëmendje se kërkesa nuk ngre pretendime për të drejta individuale zgjedhore, por për nxjerrjen e një vendimi jokushtetues nga ana e Kuvendit. Pra, në rastin

konkret nuk kemi të bëjmë me një kërkesë të paraqitur nga një individ me pretendimin për cenim të të drejtave të tij kushtetuese, por me një kërkesë për të ashtuquajtur "kontroll abstrakt" të kushtetutshmërisë të paraqitur nga shtatëmbëdhjetë deputetë, kundër një vendimi të Kuvendit. Prandaj, Gjykata do vë theksin në analizën dhe konstatimet e Raportit të Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave Penale nga Parlamenti, që shpërfaqë praktikën e disa vendeve anëtare të Këshillit të Evropës lidhur me: 1) Pamundësinë për t'u kandiduar në zgjedhje parlamentare; 2) Humbjen apo pavlefshmërinë e mandatit të anëtarit të parlamentit.

139. *Përkitazi me pamundësinë (papërshtatshmërinë) për t'u kandiduar në zgjedhje parlamentare*, Raporti i lartcekur i Komisionit të Venecias vë në dukje se në shumicën e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, çështja e pamundësisë (apo papërshtatshmërisë) për t'u kandiduar në zgjedhje parlamentare nuk është e përcaktuar me dispozita të veçanta kushtetuese, por rregullohet me ligje përkatëse (shih Raportin e Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave të Paligjshme nga Parlamenti, faqe 6-7).

140. Më tej, për sa i përket bazës ligjore për pamundësinë (papërshtatshmërinë) për t'u kandiduar për anëtar të parlamentit, Raporti i lartcekur dallon shtetet ku pamundësia e kandidimit varet nga natyra e veprës penale, si dhe shtetet ku pamundësia e kandidimit varet nga natyra e dënimit.

141. Kështu, në vende si Mbretëria e Bashkuar, Franca, Qipro, u ndalohet kandidimi për zgjedhje parlamentare personave të dënuar për një vepër penale që lidhet me zgjedhjet. Në disa vende (Islanda, Turqia, Danimarka etj.), nuk mund të jenë kandidat për zgjedhje parlamentare personat e dënuar për vepra penale që cenojnë vlerat morale (nderin, reputacionin etj). Në Kanada (vend jo anëtar i Këshillit të Evropës), për shembull, personat e dënuar për veprime korruptive gjatë pesë viteve të fundit, apo që gjinden në vuajte të dënimit me burgim, nuk mund të kandidohen për parlament. Ndërsa në Letoni, nuk mund të kandidohet në zgjedhjet parlamentare personi që është dënuar për një vepër penale të kryer me dashje. Në anën tjetër, në disa vende pamundësia e kandidimit në zgjedhje parlamentare varet nga natyra (lartësia) e dënimit për vepra penale. Në këtë grup hyjnë shtete si: Austria, Gjermania, Mali i Zi, Luksemburgu, etj. Në Gjermani, për shembull, Kodi Penal përcakton ndalim automatik (për një periudhë prej pesë vitesh) për t'u kandiduar në zgjedhje për personat e dënuar jo më pak se një vit burgim. Një numër i kufizuar shtetesh (Finlanda, Sllovenia, SHBA) nuk kanë pengesa specifike kushtetuese ose ligjore, që personat e dënuar për

vepra penale të kandidohen në zgjedhje parlamentare (shih Raportin e Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave të Paligjshme nga Parlamenti, faqe 11-13).

142. Tutje, Raporti i lartcekur i Komisionit të Venecias vë në pah se në vendet ku e drejta e kandidimit në zgjedhje parlamentare është e kufizuar, një gjë e tillë bëhet: 1) përmes ligjit, në mënyrë të përgjithshme, duke specifikuar llojin e dënimit apo veprës penale e cila pamundëson ushtrimin e të drejtës për t'u zgjedhur; ose 2) kufizimi vendoset me vendime gjyqësore, si dënim rast pas rasti (shih Raportin e Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave të Paligjshme nga Parlamenti, faqe 13).

143. Përkitazi me humbjen/pavlefshmërinë e mandatit të anëtarit të parlamentit, Raporti i lartcekur i Komisionit të Venecias thekson se më tepër se 40% e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës kanë dispozita kushtetuese lidhur me humbjen/pavlefshmërinë e mandatit të anëtarëve të parlamentit, ndërsa pjesa tjetër e shteteve këtë çështje e rregullojnë me dispozita ligjore (shih Raportin e Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave të Paligjshme nga Parlamenti, faqe 15).

144. Gjithnjë sipas analizës krahasimtare të ngërthyer në Raportin e lartcekur të Komisionit të Venecias, humbja/pavlefshmëria e mandatit parlamentar rregullohet në mënyra të ndryshme, në shtetet e përfshira në analizë (duke përfshirë edhe disa shtete jo anëtare të Këshillit të Evropës). Por, përgjithësisht ka tri baza normative që e përcaktojnë humbjen/pavlefshmërinë e mandatit të anëtarit të parlamentit: Së pari, natyra e veprës penale; së dyti, natyra e dënimit; së treti, rrethanat që shkaktojnë pamundësinë e kandidimit në zgjedhje parlamentare (shih Raportin e Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave të Paligjshme nga Parlamenti, faqe 15).

145. Grupit të parë të shteteve – ku humbja/pavlefshmëria e mandatit parlamentar ndërlidhet me natyrën e veprës penale – i takojnë, Finlanda, Franca, Italia, Malta, Qipro, Kanadaja, Portugalia, etj. Në kategorinë e veprave penale që çojnë në humbjen/pavlefshmërinë e mandatit parlamentar hyjnë: veprat penale që lidhen me procesin zgjedhor, veprat që konsiderohen veçanërisht jo morale, veprat e rënda penale, veprat penale të kryera më dashje apo vepra të tjera specifike.

146. Në grupin e dytë bëjnë pjesë shtetet ku humbja/pavlefshmëria e mandatit të deputetit ndërlidhet me natyrën (lartësinë) e dënimit. Në

këtë kuadër, në disa shtete, çfarëdo dënimi për vepër penale me vendim gjyqësor është bazë për humbjen/pavlefshmërinë e mandatit të deputetit (Shqipëri, Azerbejxhan, Estoni, Finlandë, etj). Në disa vende të tjera, humbja/pavlefshmëria e mandatit të deputetit varet nga lartësia e dënimit dhe aspekte të tjera që lidhen me dënimin. Kështu, në Kroaci dhe në Irlandë deputeti humbë mandatin nëse dënohet me burgim efektiv prej 6 muajsh ose më tepër. Në Greqi, deputeti e humbë mandatin në Parlament nëse ai/ajo humbë të drejtën e përgjithshme të votës (humbja e të drejtës së përgjithshme të votës përcaktohet me Kushtetutë dhe ligj të veçantë). Në Kanada, anëtarët e parlamentit e humbasin mandatin nëse dënohen me burgim prej dy apo më shumë vitesh. Ndërsa në disa vende, siç është Bullgaria, humbja/pavlefshmëria e mandatit parlamentar ndodhë nëse shqiptohet dënim me burgim, ekzekutimi i të cilit nuk është pezulluar.

147. Grupit të tretë i takojnë vendet ku humbja/pavlefshmëria e mandatit të deputetit ndërlidhet me plotësimin e kushteve për pamundësinë (papërshtatshmërinë) për t'u kandiduar në zgjedhje parlamentare. Pra, deputeti e humbë mandatin parlamentar nëse gjatë ushtrimit të mandatit të anëtarit të parlamentit plotësohen kushtet dhe rrethanat të cilat do ia pamundësonin atij/asaj që të kandidohet në zgjedhje parlamentare. Kjo bëhet me automatizëm apo me vendim të veçantë të parlamentit.

148. Gjithnjë duke iu referuar Raportit të Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave Penale nga Parlamenti, Gjykata vëren se praktikat e mësipërme nuk janë gjithëpërfshirëse dhe uniforme. Kështu, në vende si SHBA, Izraeli etj, humbja/pavlefshmëria e mandatit të deputetit (apo senatorit) ndodhë vetëm ne raste tepër të rralla. Në SHBA, për shembull, nuk ka dispozita shprehimore kushtetuese për humbjen e mandatit në Kongres, përveç për akte tradhtie (shih Raportin e Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave të Paligjshme nga Parlamenti, faqe 23).

149. Përkitazi me procedurën për humbjen/pavlefshmërinë e mandatit të deputetit, Raporti i lartcekur i Komisionit të Venecias vë në pah se kjo procedurë është rregulluar në mënyra të ndryshme. Në disa vende, anëtari i parlamentit humbë mandatin (diskualifikohet) me automatizëm, posa të privohet nga të drejtat e tij civile politike me vendim gjyqësor (p.sh., Belgjika). Në Estoni, kushtetuta përcakton se deputetit i ndërpritet mandati sapo të hyn në fuqi vendim gjyqësor për dënimin e tij, i cili do ia pamundësonte atij të kandidohej për deputet.

150. Në vende të tjera, parashikohet që humbja/pavlefshmëria e mandatit (diskualifikimi) realizohet përmes veprimit të caktuar në parlament. Kështu, në Danimarkë parlamenti mund t'i marrë mandatin një anëtari i cili është dënuar për një vepër e cila e bënë atë të padenjë për të mbajtur ulësen në organin ligjdhënës. Një praktikë e ngjashme ndiqet edhe në vende si Gjermania dhe Hungaria. Ndërsa në Francë, humbja e të drejtave civile shpie në humbjen e mandatit parlamentar të deputetit, por kjo konstatohet me vendim të Këshillit Kushtetues.

Kodi i Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore i Komisionit të Venecias

151. Përmes Kodit të Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore, Komisioni i Venecias sqaron mundësitë që përmes dispozitave të legjislacionit zgjedhor të behët kufizimi i të drejtave politike, duke përfshirë të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur. Në pjesën relevante, ky Kod thekson se:

> *"[...] me dispozita juridike mund të përcaktohen klauzola për suspendimin e të drejtave politike. Këto klauzola, megjithatë, duhet të jenë në pajtueshmëri me kriteret që zakonisht duhet të respektohen për kufizimin e të drejtave të njeriut, me fjalë të tjera kufizimet duhet:*
>
> *1. të parashihen me ligj;*
> *2. të respektojnë parimin e proporcionalitetit;*
> *3. të bazohen në paaftësinë mentale apo dënimin penal për vepër serioze."*

152. Për më tepër, sipas Kodit të lartcekur, në rast të marrjes së të drejtave në bazë të paaftësisë mendore, vendimi i tillë mund të ketë të bëjë me paaftësinë por të nënkuptojë *ipso jure* edhe marrjen e të drejtave civile. Ndërsa kushtet për mohimin e të drejtës së individëve për t'u zgjedhur mund të jenë më pak strikte se heqja e të drejtës për të zgjedhur (për të votuar), pasi në këtë rast është në pyetje mbajtja e një pozicioni publik [...] (shih, Kodin e Praktikave të Mira në Çështje Elektorale e Komisionit të Venecias, faqe 14).

Raporti i Komisionit të Venecias për Legjislacionin Zgjedhor dhe Administrimin e Zgjedhjeve në Evropë

153. Raporti i Komisionit të Venecias për Legjislacionin Zgjedhor dhe Administrimin e Zgjedhjeve në Evropë trajton çështjet kryesore përkitazi me legjislacionin zgjedhor dhe administrimin e zgjedhjeve në Evropë. Në pjesën relevante të këtij Raporti, lidhur me humbjen e mandatit të të zgjedhurve, Komisioni i Venecias përcaktoi më sa vijon:

"[...]
78. Nuk është e rrallë që për shkak të një dënimi penal për një vepër serioze, individëve të iu mohohet e drejta për t'u kandiduar për zgjedhje. Megjithatë, mund të jetë problematike nëse e drejta pasive e votës mohohet në bazë të një dënimi, pa marrë parasysh natyrën e asaj vepre. Një ndalesë e përgjithshme mund të mos jetë në harmoni me Konventën e Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sa i përket Ligjit për Zgjedhjet e Deputetëve të Ukrainës, për shembull, Komisioni i Venecias rekomandon që ligji duhet të garantoj mbrojte më të madhe të të drejtave të kandidatëve, duke përfshirë largimin e ndalesave të përgjithshme dhe të paqarta për kandidatët që kanë dënime penale (shih CDL-AD(2006)002, parag. 16 [17] dhe 100[101]). Rekomandimi i OSBE-ODIHR-it që e drejta për të qenë kandidat duhet të kthehet për ata që janë dënuar dhe pastaj janë falur pas trazirave post-elektorale të vitit 2003 në Azerbajxhan, shkon në të njëjtin drejtim.

79. Në anën tjetër, nuk do të ishte e duhur të mos parashihet (apo të mos zbatohet) asnjë kufizimi për përshtatshmërinë për t'u zgjedhur për kryesit e veprave panele. Për shembull delegacioni i Kongresit të Çështjeve Lokale dhe Regjionale të Këshillit të Evropës, ishe i shqetësuar lidhur me validitetin e kandidaturës për zgjedhjet e lokale të vitit 2005 në "Ish Republikën Federale të Maqedonisë". Një Kryetar Komune kishte mundësi të garonte për Kryetar përkundër që ishte dënuar nga gjykata me 4 vjet burgim për një gamë të gjerë vjedhjesh" (shih Raportin e Komisionit të Venecias për Legjislacionin Elektoral dhe Administrimin të Zgjedhjeve në Evropë, paragrafët 78 dhe 79)."

154. Si përfundim lidhur me qëndrimet e Komisionit të Venecias, në të tri dokumentet e Komisionit të Venecias të analizuara më sipër vihet theksi në përfundimin e përgjithshëm se pamundësia, përkatësisht papërshtatshmëria për t'u kandiduar në zgjedhje parlamentare, si dhe humbja e mandatit parlamentar, është një kufizim i të drejtave zgjedhore, të garantuara me nenin 3 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Prandaj, ato duhet të bazohen në norma të qarta të ligjit, të ndjekin një qëllim legjitim dhe të respektojnë parimin e proporcionalitetit. Por, po ashtu, siç e thekson fuqimisht Komisioni i Venecias, është në interesin e përgjithshëm publik të shmanget roli aktiv në vendimmarrjen politike, i shkelësve seriozë të ligjit.

Përgjigjet e marra nga Forumi i Komisionit të Venecias në pyetjet e dërguara nga Gjykata Kushtetuese

155. Gjykata në vijim do të paraqes kronologjikisht përgjigjet e shteteve të Forumit të Komisionit të Venecias. Siç është sqaruar në pjesën e procedurës para Gjykatës, kjo e fundit u kishte drejtuar pyetje anëtarëve të Forumit të Komisionit të Venecias. Përgjigje janë pranuar nga gjykatat kushtetuese/supreme të shteteve në vijim: Suedisë, Sllovakisë, Kroacisë, Republikës Çeke, Meksikës, Kirgizisë, Holandës, Bullgarisë dhe Polonisë.

156. Përgjigjet e Gjykatës Supreme të **Suedisë** dhe Gjykatës Supreme Administrative të Suedisë, theksojnë se: (a) në Suedi, nuk ndalohet me ligj që të kandidosh për anëtarë të Kuvendit (Riksdag) nëse je dënuar për vepër penale. Megjithatë, supozohet që partitë politike kanë rregulla të brendshme që parandalojnë kandidimin e personave për t'u zgjedhur nëse kanë kryer vepër penale; (b) deputeti humb mandatin për kryerjen e një vepre penale, ndërsa vendimi për të marrë mandatin e deputetit të Parlamentit (Riksdag) merret nga gjykata që vendos për veprën penale, nëse kemi të bëjmë më dënim me burgim për dy (2) vite apo më tepër; (c) në rast se një anëtar i Parlamentit (Riksdag) mungon (apo humbë mandatin), atëherë ai/ajo zëvendësohet nga një anëtar zëvendësues. Nëse edhe anëtari zëvendësues mungon, atëherë, deri sa të caktohet zëvendësuesi i tij/saj, Parlamenti (Riksdag) është i pakompletuar por vazhdon të punojë dhe të merr vendime; (d) nuk ka rregulla se sa anëtarë duhet të jenë prezent në Parlament që të ketë kuorum, edhe pse ka raste të caktuara kur një numër i caktuar i deputetëve kërkohet për të marrë një vendim. Për të marrë vendimin, shumica e anëtarëve që janë prezent duhet të votojnë "për" propozimin; dhe (e) deputeti i Parlamentit (Riksdag) ka të drejtë të votojë deri sa ai/ajo të jetë larguar nga detyra. Fakti që deputeti është shkarkuar nuk do të thotë që vendimet e mëhershme ku ai ka votuar (para se të jetë shkarkuar) janë të pavlefshme. Kjo pasi që në Suedi ligji që është miratuar mund të shfuqizohet apo ndryshohet vetëm nga Parlamentit (Riksdag), i cili mund të nxjerrë një ligj të ri, ndërsa vendimet e Parlamentit nuk mund të ankimohen apo rishikohen.

157. Përgjigja nga Gjykata Kushtetuese e **Sllovakisë** thekson se: (a) një person nuk mund të jetë kandidat për zgjedhje në Sllovaki nëse ai është dënuar për vepër penale të kryer me dashje dhe nëse vendimi është përfundimtar, përderisa dënimi nuk hiqet nga dosja e tij penale; (b) mandati i deputetit përfundon kur vendimi për dënimin e tij me burgim për vepër penale bëhet përfundimtar dhe ai dënim me burgim nuk është pezulluar; (c) nuk ka rregulla që ndalojnë punën e Kuvendit për shkak të mungesës së një deputeti, si rezultat i humbjes së

mandatit të tij; (d) numri i përgjithshëm i deputetëve për të konsideruar *"shumicën e të gjithë deputetëve Kuvendit"* është shumica e numrit të deputetëve të Kuvendit të përcaktuar në Kushtetutë, pra nga numri i përgjithshëm i 150 deputetëve sa ka Kuvendi i Sllovakisë sipas nenit 71 (3) të Kushtetutës së Sllovakisë; dhe (e) vendimet e Kuvendit të marra kur një deputet nuk ka pasur mandat të vlefshëm, dhe vota e tij ka qenë vendimtare për vendimmarrje – megjithëse nuk ka rregulla të shkruara – mund të kontestohen në Gjykatën Kushtetuese të Sllovakisë, e cila ka deklaruar se gabimet serioze procedurale të bëra nga Parlamenti mund të bëjnë që një vendim të deklarohet jo-kushtetues.

158. Përgjigja nga Gjykata Kushtetuese e **Kroacisë** sqaron se në Kroaci: (a) nuk mund të kandidohen për deputet personat që janë dënuar me vendim përfundimtar të gjykatës, me burgim efektiv me 6 muaj ose më tepër dhe nëse në momentin e nxjerrjes së vendimit për shpalljen e zgjedhjeve dënimi është duke u ekzekutuar, apo pritet të ekzekutohet. Gjithashtu, nuk mund te jenë kandidat për deputet personat të cilët janë dënuar dhe nuk janë rehabilituar sipas ligjit në fuqi, në ditën që është marrë vendimi për shpalljen e zgjedhjeve. Plotësimi i këtyre kushteve duhet të dëshmohet me certifikatë relevante nga kandidati; (b) deputeti humb mandatin nëse dënohet me vendim të pakushtëzuar dhe përfundimtar me burgim prej 6 muajsh, ose më tepër. Megjithatë, mandati i deputetit të Parlamentit përfundon në ditën në të cilën Parlamenti vendos për përfundimin e mandatit të deputetit, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 10 të Rregullores së Parlamentit të Kroacisë, dhe i cili vendim i Parlamentit publikohet në Gazetën Zyrtare; (c) Parlamenti vazhdon të funksionojë edhe kur një deputet humb mandatin; (d) votat e nevojshme për vendimmarrje në Parlament llogariten sipas numrit të përgjithshëm të mandateve/ulëseve të Parlamentit dhe jo sipas numrit të përgjithshëm të mandateve të vlefshme në momentin specifik; dhe (e) nuk ka praktikë të Gjykatës Kushtetuese që është relevante në rastin konkret. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë ka vendosur lidhur me një rast kur Parlamenti ka nxjerrë një ligj me një votë më pak (76 në vend të 77), por që deputetët që kanë vendosur kanë pasur mandat të vlefshëm për të vendosur.

159. Përgjigja nga **Republika Çeke** specifikon se në legjislacioni e këtij vendi: (a) nuk kufizohet e drejta për të qenë kandidat për zgjedhje si rezultat i kryerjes së veprave penale; (b) nuk parashihet humbja e mandatit si rezultat i kryerjes së veprave penale; (c) në rast të humbjes së mandatit të një deputeti ai zëvendësohet me një deputet tjetër dhe mandati i deputeti të ri fillon ditën e përfundimit të mandatit të deputetit që zëvendësohet. Në rast se nuk ka zëvendësim të tij, atëherë

vendi i deputetit do të mbetët i zbrazët edhe pse një situatë e tillë ende nuk ka ndodhur në praktikë; (d) përkitazi me votat e nevojshme për vendimmarrje, vota e *"të gjithë deputetëve të Parlamentit"* nënkupton shumica e numrit të përgjithshëm të mandateve të Parlamentit të parapara me Kushtetutë (në rastin e Parlamentit të Republikës Çeke, kjo nënkupton shumicën e 200 deputetëve të Parlamentit, ashtu si parashihet në Kushtetutë); dhe, (e) Kushtetuta e Republikës Çeke i jep juridiksion Gjykatës Kushtetuese të zgjidh dyshimet sa i përket humbjes së përshtatshmërisë për të mbajtur mandatin e deputetit, por vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka vetëm natyrë deklarative dhe Kushtetuta Çeke apo aktet tjera juridike nuk rregullojnë situatat kur një ish-deputet mban një mandat të pa vlefshëm në momentin e votimit.

160. Përgjigja nga Gjykata Supreme e **Meksikës** specifikon se: (a) në Meksikë sistemi juridik nuk lejon personat që janë dënuar për vepra penale dhe që aktualisht janë në vuajte të dënimit të jenë kandidat për zgjedhje, por një ndalesë e tillë nuk vlen, në parim, në rastet kur një person ka përfunduar vuajtën e dënimit; (b) për deputetët që janë duke ushtruar mandatin në mënyrë që të mund të zhvillohet procedurë penale është e nevojshme që të merret "Deklarata e ndjekjes" nga deputetët (tjerë). Nëse deputetët pajtohen, atëherë deputeti në fjalë e humb mandatin; (c) nuk ka dispozitë ligjore që parash se Parlamenti (Kongresi) nuk funksionon nëse një deputet largohet nga pozita e tij. Nëse një deputet humb mandatin, i njëjti zëvendësohet; (d) votat e nevojshme për vendimmarrje në Parlament (Kongres), në parim, janë shumica e votave të deputetëve që janë të pranishëm në seancën kur bëhet votimi. Andaj, numri i votave të nevojshme për miratimin e vendimeve nuk llogaritet në bazë të numrit të anëtarëve të ndonjërës nga dhomat e Parlamentit, përderisa shumica e deputetëve janë të pranishëm për të bërë kuorumin, varësisht prej çështjes që diskutohet; dhe, (e) megjithëse nuk ka praktikë të njëjtë me rrethanat e rastit ku një deputet pa mandat të vlefshëm ka marrë pjesë ne votim dhe kur vota e tij ka qenë vendimtare për vendimin në fjalë, Gjykata Supreme e Meksikës mund të anulojë ligje kur gjen parregullsi gjatë procedurës për miratimin e tyre.

161. Përgjigja nga Gjykata Supreme e **Brazilit** thekson se: (a) në Brazil personi që ka kryer një vepër penale nuk mund të jetë kandidat për zgjedhje për Kongres pa kaluar tetë (8) vjet nga koha kur ai/ajo ka mbajtur dënimin për vepër penale. Ndërsa sa i përket një deputeti që është duke ushtruar detyrën, afati tetë (8) vjeçar fillon të ecë nga dita kur ai/ajo e përfundon detyrën dhe jo nga dita kur janë krijuar kushtet për një papërshtatshmëri të kandidimit; (b) një deputet (kongresmen, senator) e humb mandatin e tij nëse të drejtat e tij/saj politike

suspendohen, apo dënohet për vepër penale me vendim përfundimtar. Në rastet e humbjes së të drejtave politike, ai/ajo e humb mandatin nëse vendos Dhoma e Përfaqësuesve apo Senati Federal, me shumicën absolute të votave. Ndërsa gjithashtu parashihet procedurë e veçantë që duhet ndjekur kur një deputet (kongresmen ose senator) humb mandatin, kur ai dënohet për vepër penale; (d) deputeti (kongresmeni, senatori) që humb mandatin e deputetit sipas procedurave të sipër cekura, largohet menjëherë nga pozita e deputetit dhe ai zëvendësohet nga deputeti zëvendësues; dhe, (e) në Brazil, duke u bazuar në parimin e prezumimit të pafajësisë, Gjykata Supreme Federale vendos nëse deputeti ka kryer një vepër penale dhe pastaj Senati Federal, apo Dhoma e Përfaqësuesve, vendos në mënyrë definitive për largim nga pozita. Andaj, deri sa nuk largohet nga pozita sipas procedurave të parapara, deputeti (kongresmeni, senatori) ushtron funksionin e tij/saj. Efektet e largimit nuk kanë karakter retroaktiv dhe votimi i tij i deriatëhershëm mbetet i vlefshëm.

162. Përgjigja nga Dhoma Kushtetuese e Gjykatës Supreme të **Kirgizisë** specifikon që në legjislacioni e këtij vendi: (a) nuk mund të zgjidhen deputet personat që janë në vuajtje të dënimit me vendim gjyqësor. Regjistrimi/certifikimi i një kandidati për zgjedhje duhet të tërhiqet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëse konfirmohet fakti që kandidati ka fshehur informatat për mungesën e të drejtës pasive të votës, duke përfshirë informatat për ekzistimin e dosjes penale e cila nuk është fshirë nga dosja ashtu siç parashihet me ligj; (b) mandati i deputet përfundon para kohe nëse ka një vendim gjyqësor për dënim. Largimi para kohe i deputetet bëhet me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili vendim merret jo më vonë se 30 ditë nga dita kur paraqitet baza juridike për një gjë të tillë; (c) në rast të humbjes së mandatit të një deputeti, Parlamenti funksionon normalisht; (d) në mungesë të përbërjes së Kuvendit sipas Kushtetutës, vendimet merren nga përbërja e deputetëve që kanë dhënë betimin; dhe, (e) legjislacioni në fuqi nuk ka norma që rregullojnë çështjen nëse në një votim të Parlamentit merr pjesë deputeti që nuk ka një mandat të vlefshëm.

163. Përgjigja nga Gjykata Supreme e **Holandës** sqaron se: (a) nuk mund të kandidohet për zgjedhje një person të cilit i janë kufizuar të drejtat e votimit, apo personi që është dënuar për vepër penale me burgim për të paktën një (1) vit; (b) deputeti humb mandatin nëse është dënuar me një vendim të parevokueshëm; (c) (d) dhe (e) ushtrimi i funksionit pas diskualifikimit është i paligjshëm, por diskualifikimi nuk e bënë votimin që është bërë para diskualifikimit të pavlefshëm.

164. Përgjigja nga Gjykata Kushtetuese e **Bullgarisë** specifikon që: (a) një person nuk mund të jetë kandidat për zgjedhje në Bullgari nëse ai

është në vuajte të dënimit; (b) mandati i deputetit përfundon kur shqiptohet vendimi për dënimin me heqje të lirisë për shkak të kryerjes së një vepre penale me dashje dhe kur vuajtja e dënimit nuk është shtyrë. Heqja e mandatit të deputetit, megjithatë, kërkon nxjerrjen një rezolute nga Parlamenti; (c) Parlamenti vazhdon të funksionojë përkundër faktit që një deputet humb mandatin; (d) numri i përgjithshëm i deputetëve për të konsideruar *"shumicën e të gjithë deputetëve Kuvendit"*, është shumica e numrit të deputetëve të Kuvendit (por Kuvendi zhvillon punimet nëse me tepër se gjysma e deputetëve janë prezent); (e) Kushtetuta e Bulgarisë apo legjislacioni tjetër nuk parashikojnë se çka ndodh në rast kur në një vendim të Kuvendit ka marrë pjesë një deputet që ka humbur mandatin dhe kur vota e tij ka qenë vendimtare për marrje të vendimit.

165. Përgjigja nga Gjykata Kushtetuese e **Polonisë**, specifikon se: (a) sipas Kushtetutës së Polonisë, asnjë person që është dënuar me aktgjykim përfundimtar për një vepër penale të kryer me dashje nuk mund të zgjidhet në Sejm (Dhoma përfaqësuese) dhe Senat. Ndërsa sipas legjislacionit zgjedhor që rregullon këtë çështje në mënyrë më specifike, asnjë person nuk ka drejtë për të qenë kandidat për zgjedhje nëse ai/ajo është dënuar me burgim me aktgjykim final për një vepër penale të kryer me dashje dhe të ndjekur *ex-officio* dhe/apo për një vepër penale të kryer me dashje me karakter fiskal; (b) humbja e mandatit të deputetit të Dhomës përfaqësuese, (Sejm) ndodh kur ai/ajo humb të drejtën për të qenë kandidat për deputet, si rezultat i veprave penale të cekura në pikën (a). Përfundimi i mandatit bëhet me vendim të Kryetarit të Dhomës përfaqësuese. Deputeti i Dhomës përfaqësuese që humb mandatin ka të drejtë që brenda 3 ditësh të ankohet për këtë vendim në Gjykatën Supreme të Polonisë e cila e vlerëson vendimin e lartcekur brenda 7 ditësh. Pasi një deputet të ketë humbur mandatin, sipas procedurës së lartcekur, Kryetari i Dhomës përfaqësuese ndërmerr hapa për plotësimin e vendit të lirë të deputetit të cilit i ka përfunduar mandati; (c) në rast të humbjes së mandatit të një deputeti ai/ajo zëvendësohet me një deputet tjetër, megjithatë as Kushtetuta as legjislacioni zgjedhor nuk parashohin suspendimin e funksionit legjislativ të Dhomës përfaqësuese të Parlamentit të Polonisë deri në plotësimin e pozitës së deputetit që ka mbetur e lirë; (d) lidhur me votat e nevojshme për vendimmarrje në Dhomën përfaqësuese të Parlamentit të Polonisë, *"gjysma e numrit të deputetëve"* nënkuptohet gjysmën e numrit të përgjithshëm të deputetëve të Dhomës përfaqësuese, të parapara me Kushtetutë, e që është gjysma e numrit të përgjithshëm prej 460 deputetëve. Si pasojë e humbës së mandatit të një deputeti, deri në plotësimin e vendit të lirë, nuk parashihet që të modifikohet kërkesa kushtetuese për kuorum që është i nevojshëm për të kaluar një ligj, në këtë rast, me

"gjysmën e numrit të deputetëve; dhe, (e) nuk mund të ndodh në praktikë që një deputet që ka humbur mandatin të merr pjesë në vendimmarrje për faktin që, mes tjerash, ekzistojnë procedura të shkurtra brenda së cilës Kryetari i Dhomës përfaqësuesve merr vendim për largim, si dhe Gjykata Supreme e Polonisë vendos lidhur me ankesën.

(iii) Praktikat e deritashme të Kuvendit të Republikës së Kosovës
lidhur me mbarimin ose pavlefshmërinë e mandatit

166. Gjykata sjell në vëmendje se, nga komentet e dorëzuara në Gjykatë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, vërehet se deri më tani ka pasur vetëm një rast kur një deputeti i është ndërprerë mandati dhe kjo ka ndodhur gjatë Legjislaturës së V-të të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me deputetin Rr. M.

167. Në atë rast, më 28 janar 2016, KGJK e kishte njoftuar Kryetarin e Kuvendit lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, të datës 1 dhjetor 2015, për dënimin me burgim të deputetëve Rr.M (i dënuar me katër vite burgim) dhe L.G. (i dënuar me gjashtë vite burgim). Më 1 dhjetor 2015, deputeti L.G., kishte dhënë dorëheqje nga mandati i deputetit dhe, rrjedhimisht, nuk ishte ngritur çështja e humbjes apo pavlefshmërisë së mandatit të tij.

168. Më 29 janar 2016, Kryetari i Kuvendit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 112 [Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendit], të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, kishte kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës që të bënte zëvendësimin e deputetit Rr.M.

169. Duke vepruar sipas kërkesës së Kryetarit të Kuvendit dhe në mbështetje të dispozitave ligjore përkatëse, më 11 shkurt 2016, Presidentja e Republikës së Kosovës kishte nxjerrë vendim për zëvendësimin e deputetit Rr.M, me një kandidat tjetër nga e njëjta parti politike.

170. Të njëjtën ditë, Presidentja e Republikës së Kosovës e kishte njoftuar Kryetarin e Kuvendit me vendimin për zëvendësimin e deputetit, Rr.M.

171. Në bazë të dokumenteve dhe përgjigjeve të dorëzuara nga Kuvendi, Gjykata vëren se në rastin në fjalë në Kuvend nuk ishte zhvilluar ndonjë procedurë e veçantë për marrjen apo konstatimin e pavlefshmërisë së mandati të deputetit Rr.M. Por, sapo KGJK-ja kishte informuar Kryetarin e Kuvendit për dënimin e deputetit Rr.M.,

me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Kryetari i Kuvendit i ishte drejtuar me një shkresë Presidentes së Republikës që të bënte zëvendësimin e deputetit Rr.M.

172. Në dritën e analizave të mësipërme, Gjykata në vazhdim do trajtojë çështjen e efektit që ka dënimi për një vepër penale në të drejtën për kandidim në zgjedhje parlamentare, si dhe në vlefshmërinë e mandatit të deputetit, sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore në Republikën e Kosovës. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në dukje se parashtruesit e kërkesës e mbështesin kërkesën e tyre kushtetuese kryesisht në nenin 70.3.6 të Kushtetutës – duke u thirrur në faktin që Etem Arifi është certifikuar dhe zgjedhur deputet dhe ka vazhduar ta ushtrojë mandatin e deputetit, përkundër faktit që ai ishte dënuar për vepër penale. Megjithatë, Gjykata konsideron se çështja e ngritur në këtë kërkesë është e ndërlidhur me normat kushtetuese dhe ligjore që kanë të bëjnë me efektin që ka dënimi për vepër penale edhe në të drejtën për t'u kandiduar për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas nenit 71.1 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 29.1(q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Përkitazi me efektin që ka dënimit për vepër penale në kandidimin, zgjedhjen dhe ushtrimin e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës

173. Gjykata rikujton edhe një herë se çështjet themelore kushtetuese që ngre kërkesa në shqyrtim, janë: a kishte mandat të vlefshëm Etem Arifi në kohën e nxjerrjes nga Kuvendi të vendimit të kontestuar (në votimin e të cilit deputeti në fjalë ka marrë pjesë); dhe, nëse jo, a është në pajtueshmëri me Kushtetutën vendimi i kontestuar i Kuvendit nëse në miratimin e tij ka marrë pjesë një deputet i cili nuk ka pasur mandat të vlefshëm (për më tepër, si votë përcaktuese).

174. Gjykata thekson se, në këtë rast, trajtimi i këtyre dy çështjeve është i ndërlidhur me efektin që ka dënimi për vepër penale në kandidimin, zgjedhjen dhe ushtrimin e mandatit të deputetit.

175. Për sa i përket efektit të dënimit për kryerje të veprës penale në zgjedhjen dhe ushtrimin e mandatit të deputetit, Gjykata vë në dukje se legjislacioni i zbatueshëm në Republikën e Kosovës parasheh dy situata, gjegjësisht situatën e pamundësisë (papërshtatshmërisë) për të qenë kandidat për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si rezultat i dënimit për kryerjen e veprave penale; si dhe situatën e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit të deputetit, si rezultat i dënimit për kryerjen e veprave penale. Gjykata sjellë në vëmendje se edhe qëndrimet e Komisionit të Venecias dhe përgjigjet e pranuara

nga shtetet anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, të paraqitura më sipër, vënë theksin tek këto dy situata.

176. Rrjedhimisht, Gjykata do pasqyrojë në vijim, në mënyrë të përmbledhur, kornizën normative në Republikën e Kosovës përkitazi me*: a)* pamundësinë (papërshtatshmërinë) për të qenë kandidat për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si rezultat i dënimit për vepra penale; *b)* pavlefshmëria e mandatit të deputetit si rezultat i dënimit për vepra penale. Më tutje, Gjykata do hedhë dritë mbi pyetjen se, *c)* a ekziston, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, ndonjë procedurë e veçantë që duhet të ndiqet për heqjen e mandatit të deputetit, pasi që ai/ajo të jetë dënuar me burgim prej një viti apo më tepër, me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në fund, Gjykata do të analizojë çështjen e mandatit të Etem Arifit, në dritën e përfundimeve të arritura nga trajtimi i tri çështjeve të cekura më sipër.

a) Pamundësia (papërshtatshmëria) për të qenë kandidat për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës si rezultat i dënimit për vepra penale

177. Lidhur me pamundësinë (papërshtatshmërinë) e personave për të qenë kandidat për deputet, Gjykata fillimisht i referohet nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës që përcakton se "*1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor*. [...]".

178. Gjykata më tej i referohet nenit 71 [Kualifikimet dhe Barazia Gjinore] të Kushtetutës, i cili përcakton se "*Secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë (18) vjeç ose më i madh dhe përmbush kriteret ligjore, mund të jetë kandidat për deputet*."

179. Gjykata i referohet gjithashtu nenit 73 [Pamundësia e Kandidimit], të Kushtetutës, i cili në mënyrë shprehimore përcakton rastet specifike kur një person nuk mund të kandidohet dhe as të zgjidhet deputet i Kuvendit. Kështu, paragrafi 1 i nenit 73 përcakton se *"nuk mund të kandidohen dhe as të zgjidhen deputetë të Kuvendit, pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre: (1) gjyqtarët dhe prokurorët; (2) pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës; (3) pjesëtarët e Policisë së Kosovës; (4) pjesëtarët e Doganave të Kosovës; (5) pjesëtarët e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë; (6) udhëheqësit e agjencive të*

pavarura; (7) përfaqësuesit diplomatikë;(8) kryetarët dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve".

180. Gjykata i referohet edhe paragrafit 2 të nenit 73, që përcakton se *"[n]uk mund të kandidohen për deputetë personat e privuar nga zotësia juridike për të vepruar, me vendim përfundimtar të gjykatës."* Ndërsa paragrafi 3 i nenit 73, përcakton se *"Kryetarët dhe zyrtarët e tjerë, të cilët mbajnë përgjegjësi ekzekutive në nivel komune, nuk mund të zgjidhen si deputetë të Kuvendit pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre."*

181. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se neni 73 [Pamundësia e Kandidimit], i Kushtetutës, nuk përcakton në mënyrë shprehimore se personat e dënuar për vepra penale nuk mund të kandidojnë për deputet të Kuvendit të Kosovës.

182. Megjithatë, Gjykata vë theksin në nenin 71 [Kualifikimet dhe Barazia Gjinore], të Kushtetutës, i cili përcakton se "*Secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë (18) vjeç ose më i madh dhe* ***përmbush kriteret ligjore****, mund të jetë kandidat për deputet."* Në këtë aspekt, është kërkesë kushtetuese e paraparë në nenin e lartcekur të Kushtetutës që në mënyrë shprehimore përcakton se për t'u kandiduar për deputet, secili person duhet të përmbush, përveç kriterit të moshës dhe shtetësisë, edhe *"kriteret ligjore"*. Nga kjo dispozitë kushtetuese rrjedhë se Kuvendi i Kosovës mund të përcaktojë kritere shtesë, përmes ligjit, në mënyrë që një person të kandidohet për të qenë deputet.

183. Në këtë vazhdë, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, në nenin 29 [Përshtatshmëria/Aftësia e Kandidatit], paragrafi 1, përcakton ndër të tjera se:

> 29.1. *"cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve është i aftë për certifikim si kandidat përveç nëse ai apo ajo:*
>
> *[...]*
>
> *o) me anë të vendimit të gjykatës, përfshirë edhe vendimin e PZAP-it i është hequr e drejta për të qenë kandidat;*
>
> *p) me anë të vendimit të gjykatës, i është hequr e drejta për të qenë kandidat;*
>
> *q) i shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit;*
>
> *[...]"*

184. Sipas kësaj dispozite ligjore, një person, përveç se duhet të plotësoj kriteret tjera të parapara me Kushtetutë dhe ligj, nuk mund të jetë

kandidat për deputet në zgjedhje parlamentare nëse "*me anë të vendimit të gjykatës, përfshirë edhe vendimin e PZAP-it i është hequr e drejta për të qenë kandidat*", apo nëse *"është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit"*.

185. Gjykata e konsideron të rëndësishme të vë në dukje se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dallon situatat kur personave iu hiqet e drejta për të qenë kandidat në zgjedhje parlamentare me vendim shprehimor gjyqësor (apo të PZAP-së), me situatat kur një gjë e tillë iu pamundësohet për shkak se janë shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit.

186. Për më tepër, sa i përket kriterit që një person të mos jetë shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit, Gjykata vëren se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk specifikon natyrën e veprës penale dhe sanksionit penal të shqiptuar, në mënyrë që një person të diskualifikohet nga mundësia për të qenë kandidat për deputet, me kushtin që personi të jetë: *"shpallur fajtor për veprën penale"* me *"vendim përfundimtar të gjykatës"* dhe me kushtin që kjo të këtë ndodhur në *"tri (3) vitet e fundit"*.

187. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata vë në dukje se neni 29 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i atribuon KQZ-zë kompetencën ekskluzive për të bërë vlerësimin e kushteve formale të kandidateve me rastin e aplikimit dhe certifikimit të tyre për të marrë pjesë në zgjedhje. Paragrafi 4 i këtij neni përcakton se *"nëse kandidati i cili është certifikuar nga KQZ-ja është apo ka arritur statusin sipas të cilit ai apo ajo humb aftësinë për të qenë kandidat sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, ai person decertifikohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe largohet nga lista e kandidatëve të subjektit politik në fjalë*".

188. Sidoqoftë, Gjykata sjellë në vëmendje përgjigjen e pranuar nga KQZ-ja dhe të përsëritur nga Kryetarja e KQZ-së gjatë seancës dëgjimore, ku ajo ka sqaruar veprimet që ndërmerr KQZ-ja në zbatim të nenit 29, paragrafi 1, pika (q), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ky nen përcakton se personat që paraqiten në listën e votuesve duhet të mos jenë shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit. Lidhur me këtë, KQZ-ja sqaroi se në Aktgjykimin AA.-Uzh.nr.16/2017, të 19 shtatorit 2017, Gjykata Supreme ka konstatuar se *"askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje, nëse një e drejtë e tillë nuk i është hequr me vendim gjyqësor, e që do të thotë, se kandidati duhet me vendim të formës së prerë, të shpallet fajtor dhe gjykata, t'i ketë shqiptuar*

dënimin plotësues "heqjen e të drejtës për tu zgjedhur". KQZ më tutje ka sqaruar se që nga viti 2017, përkatësisht nga nxjerrja e këtij Aktgjykimi të Gjykatës Supreme *"[...] vetëm nëse ZRPPC/KQZ do të kishte hasur në vendim gjyqësor me emërtimin "heqja e të drejtës për tu zgjedhur" do e merrte në konsideratë për të mos rekomanduar, gjegjësisht, mos certifikuar ndonjë kandidat të ndonjë subjekti politik"*.

189. Ndërsa lidhur me Etem Arifin, KQZ thekson se *"nuk ka qenë dhe nuk është e informuar që me vendim të formës së prerë i është ndaluar z. Arifi, para datës 10 shtator 2019 kur është certifikuar, që të jetë kandidat për deputet"*. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dhe Kryetarja e KQZ-së kanë theksuar se Etem Arifi, në formularin që ka plotësuar në KQZ me rastin e kandidimit për deputet, nuk ka dhënë informatën që ai ka qenë i dënuar (dhe rrjedhimisht, nuk ka plotësuar kushtet e kërkuara nga neni 29.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme), për tu kandiduar për deputet.

190. Gjykata vë në dukje se neni 45 i Kushtetutës, në të cilin është thirrur Gjykata Supreme për të nxjerrë Aktgjykimin e saj të 19 shtatorit 2017, në paragrafin 1, përcakton se: *"Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor"*.

191. Gjykata thekson se neni 45 i Kushtetutës flet përgjithësisht për të drejtat zgjedhore, duke përcaktuar në mënyrë të përgjithësuar se ato mund të kufizohen me vendime gjyqësore - pa saktësuar natyrën e atyre vendimeve dhe pa kërkuar shprehimisht që ato vendime të jenë për heqjen e të drejtave zgjedhore. Ndërsa neni 71 i Kushtetutës përcakton kushtet që duhet plotësuar specifikisht për të kandiduar për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

192. Në dritën e kësaj, Gjykata konsideron se, së pari, neni 45 i Kushtetutës flet për "*kufizimet*" e të drejtave zgjedhore, me gjuhë të përgjithësuar; së dyti, termi "*vendim gjyqësor*", në kuptim të këtij neni, nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që të nënkuptojë ekskluzivisht dhe vetëm vendimet gjyqësore plotësuese *"heqja e të drejtës për tu zgjedhur"*. Pra, një interpretim tekstual dhe logjik i gjuhës së këtij neni, në ndërlidhje sistematike me nenin 71 të Kushtetutës dhe nenin 29.1 (q), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, shpie në përfundimin se edhe vendimet gjyqësore me të cilat qytetarët dënohen për vepra penale mund të "kufizojnë" të drejtat zgjedhore. Gjykata sjellë në vëmendje se një interpretim i tillë përputhet edhe me praktikën e shumicës

dërmuese të vendeve anëtare të Komisionit të Venecias, siç është pasqyruar në dokumentet dhe përgjigjet e paraqitura më lartë.

193. Për më tepër, Gjykata vë në dukje se, lidhur me çështjen e kufizimit të të drejtave kushtetuese, është i pashmangshëm referimi edhe në nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], të Kushtetutës. Ky nen përcakton se të drejtat e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë mund të kufizohen në raste të caktuara dhe, sipas Gjykatës, kjo përfshinë edhe të drejtat zgjedhore të parapara me nenin 45 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 55 të Kushtetutës, i cili përcakton:

1. "Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.

4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar".

194. Në dritën e këtyre dispozitave kushtetuese, Gjykata thekson se të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat zgjedhore, mund të kufizohen nëse plotësohen kriteret poshtëshënuara në mënyrë kumulative:

b. nëse kufizimi i të drejtave është i paraparë me ligj;
c. nëse kishte një qëllim legjitim që synohej të arrihet me kufizim; *dhe*

d. nëse ndërhyrja "është e nevojshme në një shoqëri demokratike" apo nëse kishte një marrëdhënie proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të të drejtave dhe qëllimit legjitim të ndjekur (shih*, mutatis mutandis,* rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO157/18, parashtrues: *Gjykata Supreme e Kosovës*, Aktgjykim i 13 marsit 2019, paragrafi 91).

195. Një interpretim i tillë është në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në interpretimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe në raportin përkatës të Komisionit të Venecias.

196. Për sa më sipër, Gjykata konsideron se, sipas nenit 71 të Kushtetutës, secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë vjeç ose më i madh dhe përmbush kriteret ligjore, mund të jetë kandidat për deputet. Ndërsa sipas nenit 29.1(q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, asnjë person nuk mund të jetë kandidat për deputet për zgjedhjet për Kuvend nëse është dënuar për vepër penale me vendim përfundimtar të Gjykatës në tri vitet e fundit. Siç u tha më lartë dhe siç është pasqyruar nga Raporti i Komisioni të Venecias dhe nga përgjigjet e vendeve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, një praktikë e tillë e pamundësisë së kandidimit në zgjedhje parlamentare për personat e dënuar për vepra penale, me disa dallime të vogla, ndiqet edhe nga shumë vende demokratike. Një kufizim i tillë i shërben qëllimit parësorë të ruajtjes së integriteti kushtetues dhe besueshmërisë qytetare në organin ligjdhënës – si shtyllë themeltare e rendit demokratik.

197. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata e konsideron të rëndësishme të vë në dukje ekzistimin e paqartësive përkitazi me zbatimin e nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kjo gjë u dëshmua edhe nga përgjigjet dhe argumentet e paraqitura gjatë seancës dëgjimore. Gjykata, megjithatë, thekson se neni 29 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk lejon kandidimin për deputet (ndër të tjera) të personave të shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit. Për më tepër, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme parasheh që nëse një kandidat i cili është certifikuar nga KQZ-ja, është apo ka arritur statusin sipas të cilit ai apo ajo humb aftësinë për të qenë kandidat sipas dispozitave të paragrafit 1 të nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ai person decertifikohet nga KQZ-ja dhe si i tillë nuk mund të jetë kandidat për deputet.

198. Gjykata vë në dukje se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk kërkon që personave të dënuar për vepra penale t'iu shqiptohet medoemos si dënim plotësues *"heqja e të drejtës për t'u zgjedhur"*, në mënyrë që ata

të mos lejohen të kandidojnë në zgjedhje parlamentare. Kjo meqë, sipas nenit 29.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, heqja e të drejtës për të qenë kandidat në zgjedhje me vendim të PZAP-së dhe gjykatës, si dhe pamundësia për të qenë kandidat për shkak të shpalljes fajtor për një vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundi, janë baza të ndryshme/të ndara që shkaktojnë pamundësinë/papërshtatshmërinë për të qenë kandidat. Gjykata është e mendimit se ky interpretim përputhet edhe me leximin sistematik të neneve 45, 55 dhe 71 të Kushtetutës.

199. Gjykata konsideron se po të ndiqet interpretimi i lartcekur i Gjykatës Supreme, atëherë gjykatat e rregullta do duhej që kurdo që shqiptojnë aktgjykime dënuese për vepra penale të shqyrtojnë, në mënyrë krejtësisht hipotetike, mundësinë që personave të dënuar t'iu shqiptojnë edhe dënime plotësuese me heqje të të drejtës për t'u zgjedhur (konform kritereve të parapara me Kodin Penal). Nuk mund të pritet nga gjykatat e rregullta që sa herë që vendosin për shqiptimin e dënimeve për vepra penale, të nxjerrin supozime se cilët nga kryesit e veprave penale do të mund të kandidojnë, potencialisht, për zgjedhje në të ardhmen.

200. Më tutje, Gjykata dëshiron të nënvizojë se Gjykata Supreme, në Aktgjykimin AA.-Uzh.nr.16/2017, të 19 shtatorit 2017, as nuk kishte bërë interpretimin e dispozitës ligjore, gjegjësisht nenit 29.1(q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në raport e kufizimet e parapara në nenin 45 në ndërlidhje me nenit 55 dhe 71 të Kushtetutës, dhe as nuk i ishte drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij. Gjykata sjellë në vëmendje se Gjykata Supreme ka mundur të referojë në Gjykatën Kushtetuese çështjen e kushtetutshmërinë së nenit 29.1(q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, konform paragrafit 8 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, lidhur me rastin që kishte para saj.

201. Në lidhje me këtë, Gjykata sqaron se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme vazhdon të mbetet në fuqi – me të gjitha nenet dhe dispozitat e tij – përderisa ai nuk ndryshohet nga Kuvendi, apo nuk kontestohet jo kushtetutshmëria e tij para Gjykatës Kushtetuese.

202. Gjykata sjell në vëmendje Aktgjykimin e saj në rastin KI207/19, ku Gjykata Kushtetuese ka qartësuar se "*përkundër faktit që Kushtetuta ia njeh gjykatave të rregullta kompetencën e interpretimit të një norme të rangut ligjor në harmoni me një normë të rangut kushtetues dhe/ose aplikimin e drejtpërdrejtë të normës së rangut kushtetues, kjo nuk do të thotë se gjykatat e rregullta mund të konstatojnë ose të*

shpallin një normë ligjore si normë në kundërshtim me Kushtetutën [...] Një të drejtë të tillë, Kushtetuta ia ka mveshur në mënyrë ekskluzive vetëm Gjykatës Kushtetuese" (shih rastin nr. KI207/19, Parashtrues NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 259).

203. Rrjedhimisht, Gjykata dëshiron të qartësojë se në këtë rast nuk është objekt shqyrtimi para Gjykatës çështja e kushtetutshmërisë së nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, sikundër që nuk është kontestuar para kësaj Gjykata as kushtetutshmëria e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Uzh.nr.16/2017, të 19 shtatorit 2017. Prandaj, Gjykata është e kufizuar në analizimin e dispozitave të Ligjit të lartpërmendur vetëm për aq sa ato ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret.

204. Në dritën e kësaj, Gjykata sjellë në vëmendje se pyetja thelbësore që ngërthen kërkesa e parashtruesve në këtë rast është se a ka pasur mandat të vlefshëm Etem Arifi kur është votuar në Kuvend vendimi i kontestuar. Në këtë vazhdë, përveç çështjes së pamundësisë (papërshtatshmërisë) për të qenë kandidat në zgjedhje parlamentare, kërkesa ngre pretendime që ndërlidhen edhe me dispozitat kushtetuese dhe ligjore që kanë të bëjnë me rastet kur mandati i një deputeti të Kuvendit të Republikës së Kosovës mbaron, apo bëhet i pavlefshëm, si rezultat i dënimit për vepra penale.

b. Pavlefshmëria e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës si rezultat i dënimit për vepra penale

205. Gjykata fillimisht thekson se neni 70 [Mandati i Deputetëve] rregullon çështjen e mandatit të deputetëve, duke përcaktuar në paragrafin 2 se *"[m]andati i deputetit të Kuvendit të Kosovës fillon ditën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjes"*.

206. Ndërsa paragrafi 3 i nenit 70 të Kushtetutës, parasheh rastet se kur mandati i një deputeti mbaron apo bëhet i pavlefshëm, duke përcaktuar 7 raste kur një gjë e tillë mund të ndodhë.

207. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se neni 70 i Kushtetutës përmend "mbarimin" dhe "pavlefshmërinë" e mandatit të deputetit. Megjithatë, ky nen nuk bënë dallim, në mënyrë shprehimore, në mes të rasteve kur mandati mbaron, përkatësisht bëhet i pavlefshëm. Mandati i deputetit, sipas nenit 70 paragrafi 3 të Kushtetutës, mbaron ose bëhet i pavlefshëm nëse ai/ajo:

"(1) nuk bën betimin;

(2) jep dorëheqjen;
(3) emërohet anëtar i Qeverisë së Kosovës;
(4) përfundon mandati i Kuvendit
(5) mungon gjashtë (6) muaj rresht në seancat e Kuvendit. Në raste të veçanta, Kuvendi i Kosovës mund të vendosë ndryshe;
(6) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale me një ose më shumë vjet burgim;
(7) ajo/ai vdes."

208. Gjykata vë theksin në nenin 70, paragrafi 3, nënparagrafi 6, i cili përcakton se mandati i deputeti mbaron apo bëhet i pavlefshëm nëse ai apo ajo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me një ose më shumë vjet burgim.

209. Dispozita të ngjashme me nënparagrafin 6 të paragrafit 3 të nenit 70, janë paraparë edhe në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, konkretisht në nenin 112 [Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendit], paragrafi 112.1. a, ku përcaktohet se: *"Mandati i anëtarit nuk do të ndryshohet apo ndërpritet para se të përfundoj mandati përveç ne rastet vijuese: a) dënimi i anëtarit për vepër penale për të cilën ai apo ajo është dënuar me burgim sikurse parashikohet me anë të nenit 69.3 (6) të Kushtetutës* [70.3 (6)]."

210. Për më tepër, Gjykata vëren se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, në nenin 112 [Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendit], paragrafi 1, pika c), përcakton se *"Mandati i anëtarit [të Kuvendit] nuk do të ndryshohet apo ndërpritet para se të përfundoj mandati përveç ne rastet vijuese:* [...] *c) humbja e mandatit të anëtarit [të Kuvendit], sipas nenit 29 të këtij ligji"*. Pra, neni 112.1.c i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i referohet humbjes së mandatit të deputetit edhe nëse krijohet ndonjëra nga kushtet/rrethanat e parapara në nenin 29 të këtij Ligji. Një qasje e tillë e mishëruar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, është në përputhshmëri edhe me praktikën e shumë vendeve anëtarë të Komisionit të Venecias, siç është shtjelluar në Raportin e Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave Penale nga Parlamenti.

211. Ndërsa neni 29 i Ligjit në fjalë përcakton, ndër të tjera, edhe pamundësinë për të kandiduar në zgjedhjet parlamentare për personat të cilët janë shpallur fajtor për vepër penale në tri vitet e fundit para zgjedhjeve (nenin 29.1.q). Rrjedhimisht, interpretimi i ndërlidhur i nenit 112.1.c dhe 29.1.q të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, praktikisht çon në përfundimin se mandati i deputetit humbet nëse plotësohen ndonjë nga rrethanat të cilat do ia

pamundësonin atij për t'u kandiduar në zgjedhje parlamentare për deputet të Kuvendit.

212. Gjykata, gjithashtu, rikujton Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, konkretisht nenin 8 [Përfundimi i Mandatit] paragrafi 1, pika 1.6 ku parashihet se *"Mandati i Deputetit/es përfundon para kohe: [...] nëse me vendimin e formës së prerë të gjykatës dënohet për vepër penale me vuajtje të dënimit për një ose më shumë vjet burg."* E njëjta dispozitë parashihet edhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit, konkretisht nenin 25 [Humbja e statusit të deputetit të Kuvendit] e cila në paragrafin 1, pika d, parasheh se *"Deputeti i Kuvendit e humb mandatin, nëse: [...] dënohet për një vepër penale me burgim për një periudhë kohore prej një (1) e më shumë vjet [...]."*

213. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se korniza përkatëse kushtetuese dhe ligjore përcakton në mënyrë të qartë se mandati i deputetit mbaron apo bëhet i pavlefshëm nëse ai/ajo, *"dënohet me vendim gjyqësor"; "dënimi është për një vepër penale"*; "*dënimi është me burgim për një periudhë kohore prej një (1) e më shumë vjet"; "vendimi i gjykatës është i formës së prerë"*. Pra, në momentin kur plotësohen kumulativisht katër rrethanat e lartcekura ndaj një deputeti të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ai/ajo e humb mandatin.

214. Gjykata sjellë në vëmendje se në këtë vijë është edhe Aktgjykimi i saj në rastin KO 98/11, ku kishte theksuar se: "[...] *Kushtetuta parashikon kur mandati mund të përfundojë para kohe. Në lidhje me situatën <u>kur ekziston</u> vendimi gjyqësor i formës se prerë me të cilin një deputet dënohet me një ose më shumë vjet burgim, deputetit i hiqet mandati dhe prandaj mandati i tij/saj përfundon dhe ai/ajo më nuk i gëzon privilegjin dhe imunitetin që shkojnë me mandat [...]"*.

215. Lidhur me atë se kur një person dënohet me burgim me vendim të "formës së prerë", Gjykata i referohet Kodit të Procedurës Penale, i cili në nenin 485 [Forma e prerë dhe ekzekutueshmëria e vendimit], parasheh se:

> *1. Aktgjykimi merr formë të prerë kur më nuk mund të kundërshtohet me ankesë ose kur nuk lejohet ankesë.*

216. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata i referohet edhe nenin 407 [Ankesa në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit], i cili përcakton se:

> *1. Ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit mund të*

paraqitet në Gjykatën Supreme të Kosovës në rastin kur Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin ose kur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ose Gjykatës së Apelit i është shqiptuar dënimi me burg të përjetshëm.

217. Në dritën e kësaj, Gjykata thekson se, sipas dispozitave të lartcekura të Kodit të Procedurës Penale, vendimi gjyqësorë konsiderohet që është i formës së prerë, nëse ndaj atij vendimi nuk lejohet me tej ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike, konkretisht i ankesës.

218. Mbi këtë sfond kushtetues dhe ligjor, Gjykata arrin në përfundimin se mandati i deputetit të Kuvendi të Republikës së Kosovës mbaron apo bëhet i pavlefshëm kur atij i shqiptohet dënim me burgim prej një viti apo më tepër, me vendim gjyqësor i cili nuk mund të atakohet me ankesë, si mjet i rregullt juridik në procedurën penale.

219. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se Etem Arifit i ishte shqiptuar aktgjykim dënues nga Gjykata e Apelit, fillimisht me 28 mars 2019 dhe, pas kthimit të çështjes në rigjykim, atij i ishte konfirmuar dënimi me një vit e tre muaj burgim me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR, nr. 328/19, të datës 20 gusht 2019. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton edhe përgjigjen e KGJK se, *"[s]ipas legjislacionit në fuqi aktgjykimi merr formën e prerë në datën kur vendoset nga Gjykata e Apelit sipas ankesës, që në këtë rast është data 20.08.2019."*

c. Nëse ekziston një procedurë e veçantë që duhet të ndiqet për heqjen e mandatit të deputetit, pas dënimit me burgim prej një vit apo më tepër, me vendim gjyqësor të formës së prerë?

220. Gjykata fillimisht e konsideron të rëndësishme të rikujtojë se, para konstituimit të Kuvendit, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, themelohet Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve. Ky Komision, sipas paragrafit 4 të nenit 9 të Rregullores së Kuvendit, *"shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve, ia paraqet Kuvendit raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit dhe e verifikon kuorumin në mbledhjen konstituive të legjislaturës së Kuvendit"*.

221. Në lidhje me këtë, Gjykata sjellë në vëmendje se në rastin konkret Komisioni i lartcekur paraqiti Raportin e tij për verifikimin e

mandateve para Kuvendit, bazuar ekskluzivisht në Vendimin e KQZ-së, nr. 1845/2019, të datës 27 nëntor 2019, për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 6 tetor 2019, se bashku me listën përfundimtare të kandidateve ku përfshihej edhe emri i Etem Arifit.

222. Më tutje, Gjykata vë në dukje se as neni 70 i Kushtetutës dhe as ndonjë dispozitë tjetër kushtetuese apo ligjore nuk përcakton ndonjë procedurë të veçantë që duhet ndjekur për t'ia marrë mandatin deputetit, apo për të konstatuar mbarimin apo pavlefshmërinë e mandatit të tij – pasi të jenë krijuar rrethanat e parapara në nenin 70, 3 (6) të Kushtetutës. Gjykata sjellë në vëmendje se ky konstatim u përforcua edhe nga argumentet dhe interpretimet e palëve të paraqitura në seancë dëgjimore.

223. Ndërsa sa i përket zëvendësimit të deputetit që ka humbur mandatin, Gjykata thirret në nenin 70.4 të Kushtetutës, si dhe paragrafin 3 të nenit 112 [Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendit], të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kështu, neni 70.4 i Kushtetutës përcakton se "*vendet e liruara të deputetëve në Kuvend, plotësohen menjëherë, në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligjin*". Kjo dispozitë e përgjithshme kushtetuese zbërthehet përmes nenin 112.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton se "*Pasi që një ulëse të mbetet e zbrazët, Kryetari i Kuvendit i bën kërkesë me shkrim Presidentit për mbushjen e ulëses së zbrazët. Një kërkesë e tillë duhet të përfshij edhe sqarimin se pse u lirua kjo ulëse.*" Ndërsa paragrafi 4 i këtij neni përcakton se *"[p]as pranimit të kërkesës sipas paragrafit 3 të këtij neni, nëse sqarimi i dhënë është i mjaftueshëm, Presidenti duhet të kërkojë nga KQZ-ja të rekomandojë emrin e personit për ta mbushur vendin e lirë. KQZ-ja duhet që në afatin prej pesë (5) ditëve të punës nga momenti i marrjes së kërkesës, t'ia ofrojë Presidentit emrin e radhës së personit të ligjshëm sipas paragrafit 2 të këtij neni*".

224. Gjykata vëren, ashtu siç ka sqaruar më lart, se as Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe as ndonjë akt tjetër normativ nuk parashohin ndonjë procedurë të saktë për të konstatuar se kur *"ulësja e deputetit mbetet e zbrazët"*, por me aktet normative gjegjëse përcaktohet vetëm procedura se si plotësohet *"një ulëse që ka mbetur e zbrazët*.

225. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata i referohet edhe përgjigjes që ka marrë nga Sekretaria e Kuvendit lidhur me praktikat e deritashme të humbjes/pavlefshmërisë së mandatit të deputetit në rast të kryerjeve të veprës penale. Kështu, Gjykata rikujton se Kuvendi i Republikës së Kosovës ka pasur vetëm një rast kur i është marrë mandati një

deputeti, si pasojë e dënimit për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë (rasti i ish deputetit Rr.M). Gjykata rikujton se në atë rast, deputeti ishte dënuar me 1 dhjetor 2015, ndërsa KGJK kishte informuar Kryetarin e Kuvendit, me 28 janar 2016, lidhur me Aktgjykimin dënues të Gjykatës së Apelit. Ndërsa me 29 janar 2016, Kryetari i Kuvendit kishte kërkuar nga Presidentja zëvendësimin e deputetit në fjalë, në përputhje me nenin 112.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

226. Gjykata po ashtu vë në dukje edhe përgjigjen që Komisioni për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete i kishte dërguar Kryetares së Kuvendit (me 12 maj 2020), ku argumentohet se "*[...] asnjë dispozitë e Rregullores së Kuvendit nuk flet për rastet kur deputeti e humb mandatin Ipso jure, përveç në rastin siç përcaktohet me nenin 70, paragrafi 3, nënparagrafi 5 i Kushtetutës, së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 paragrafi 1 pika e) e Rregullores së Kuvendit [...]. Pra në bazë të Rregullores së Kuvendit, Komisioni përkatës për Legjislacion, shqyrton çështjen e mandatit të deputetit vetëm në rastet siç përcaktohet me nenin 25 paragrafi 1 pika e) e Rregullores së Kuvendit"* [Mospjesëmarrja për 6 muaj rresht në asnjë mbledhje të Kuvendit].

227. Në dritën e kësaj, Gjykata vë në pah se nga përgjigjet e pranuar nga shtetet anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, si dhe nga Raporti i Komisionit të Venecias, të cekura më lart, rezulton se nuk ka një praktikë uniforme lidhur me atë se si procedohet çështja e humbjes së mandatit të një deputeti. Kështu, në disa vende evropiane ekzistojnë dispozita kushtetuese apo ligjore që përcaktojnë një procedurë të veçantë që duhet ndjekur (në parlamentet përkatëse) pas shqiptimit të dënimit për vepër penale ndaj deputetit. Respektimi i kësaj procedure të paraparë është parakusht që mandati i deputetit të përfundoj formalisht. Ndërsa në disa vende të tjera kjo çështje nuk është e rregulluar dhe konstatimi apo formalizimi i humbjes së mandatit të deputetit nuk kërkon ndonjë procedurë apo votim të veçantë në parlament (trupa gjegjëse), por humbja e mandatit është automatike dhe e ndërlidhur me vendimin e formës së prerë të gjykatës.

228. Gjykata rithekson se as në Kushtetutën e Kosovës e as në ligjet dhe rregulloret përkatëse nuk ka një procedurë të përcaktuar posaçërisht që duhet ndjekur për konstatimin e humbjes së mandatit, pasi të jenë plotësuar kushtet për mbarimin apo pavlefshmërinë e mandatit të deputetit, për shkak të dënimit me burgim një vit e më tepër (siç e parasheh neni 70. 3.6. i Kushtetutës dhe nenet përkatëse të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit).

229. Gjykata rithekson se në praktikat e mëhershme të Kuvendit ekziston vetëm një rast kur një deputeti i ka përfunduar mandati si rezultat i kryerjes së veprës penale. Në atë rast, sipas dosjes së lëndës, nuk ka informata që është ndjekur ndonjë procedurë specifike në Kuvend për heqjen e mandatit, përveç procedurës për zëvendësimin e deputetit të cilit i ka përfunduar mandati. Rrjedhimisht, pas humbjes së mandatit të deputetit në fjalë, Kryetari i Kuvendit kishte kërkuar nga Presidentja zëvendësimin e deputetit të cilit i kishte përfunduar mandatit, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

230. Gjykata rikujton, edhe një herë, se çështja e pamundësisë për të qenë kandidat për deputet të Kuvendit është e përcaktuar në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, duke përfshirë nenet 71, dhe 73 të Kushtetutës, si dhe nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Po ashtu, çështja e humbjes, apo pavlefshmërisë, së mandatit të deputetit është rregulluar me nenin 70 të Kushtetutës, nenin 112 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 8 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit si dhe nenin 25 të Rregullores së Kuvendit.

231. Gjykata vë në dukje se Kushtetuta në mënyrë shprehimore e ka paraparë rastin në të cilin humbja e mandatit nuk është automatike, por i nënshtrohet një procedure të veçantë në Kuvend, përkatësisht në rastet kur një deputet mungon gjashtë (6) muaj në seancat e Kuvendit, përpos nëse Kuvendi vendos ndryshe, siç është përcaktuar shprehimisht në pikën 5 të paragrafit 3 të nenit 70 të Kushtetutës.

232. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata thekson se sikur qëllimi i ligjdhënësit do të ishte që marrja e mandatit të deputetit, pas shqiptimit të vendimit të formës së prerë për dënim me një vit e më tepër burgim, t'i nënshtrohej ndonjë procedure të caktuar, qoftë përmes një votimi formal nga Kuvendi apo ndonjë procedure tjetër, kjo procedurë do të ishte përcaktuar ose në dispozita kushtetuese ose me ndonjë nga ligjet përkatëse apo me Rregulloren e Kuvendit.

233. Një procedurë e tillë nuk mund të përcaktohet nga Gjykata Kushtetuese, nëse ajo nuk është paraparë në asnjë akt normativ dhe, për më tepër, në mungesë të një praktikë të etabluar në Kuvend lidhur me këtë çështje (pasi siç u theksua, nga përgjigjet e Sekretaria e Kuvendit rezulton se deri më tani ka pasur vetëm një rast të tillë).

234. Megjithatë, Gjykata thekson se mbi faktin e mungesës së një procedure të tillë të posaçme, nuk mund të konstruktohen interpretime të tilla kushtetuese që do t'i zhvishnin nga efekti praktik

nenin 70.3.6 të Kushtetutës, nenin 112.1. a dhe c të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 8.1.6 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, si dhe nenin 25 të Rregullores së Kuvendit. Gjykata konsideron se qëllimi i nenit 70.3.6 të Kushtetutës dhe neneve ligjore në fjalë, që burojnë prej tij, është që të mos i mundësohet ushtrimi i mandatit një deputeti i cili është i dënuar me një vit apo më tepër burgim.

235. Prandaj, Gjykata arrin në përfundim se, në mungesë të një procedure të veçantë për konstatimin e humbjes, përkatësisht pavlefshmërisë së mandatit të deputetit, mandati i deputetit humbë apo bëhet i pavlefshëm nga momenti i nxjerrjes së vendimit të formës së prerë gjyqësor me të cilin ai/ajo dënohet me një vjet e më tepër burgim. Pra, në mungesë të një procedure të tillë, humbja e mandatit është automatike dhe fillon nga momenti i nxjerrjes së vendimit të formës së prerë gjyqësor për dënim të deputetit për vepër penale me një vjet e më tepër burgim.

236. Në anën tjetër, korniza ligjore përcakton qartë procedurën që duhet ndjekur për zëvendësimin e një deputeti që ka humbur mandatit, gjegjësisht kur *"ulësja e deputetit mbetet e zbrazët"* (nenin 112.3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme). Kjo paraqet një moment tjetër kushtetues e ligjor, që pason mbarimin apo pavlefshmërinë e mandatit të deputetit. Lidhur me zëvendësimin e deputetëve mandati i të cilëve ka mbaruar apo është bërë i pavlefshëm, Kuvendi (gjegjësisht Kryetari/Kryetarja e tij), në përputhje me nenin 112.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, duhet të ndërmarrë veprimet e parashikuara ligjore për zëvendësimin e deputetit, sapo të njoftohet zyrtarisht se ekziston një vendimi i formës së prerë gjyqësor me të cilin një deputet është i dënuar me një vjet e më tepër burgim. Kushtetuta, në paragrafin 4 të nenit 70 të saj, qartësisht përcakton se "vendet e liruara", duhet të plotësohen/zëvendësohen "menjëherë".

237. Duke pasur parasysh konstatimet e mësipërme lidhur me efektin e dënimit për vepra penale, në pamundësinë e kandidimin për zgjedhje parlamentare dhe humbjen e mandatit të deputetit, Gjykata në vazhdim do të vlerësojë nëse, në rastin konkret, Etem Arifi kishte mandat të vlefshëm gjatë zhvillimit të procedurës për nxjerrjen se vendimit të kontestuar.

I. Nëse Etem Arifi kishte mandat të vlefshëm me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar

238. Fillimisht, Gjykata rikujton se më 20 prill 2018, Gjykata Themelore kishte shpallur fajtor Etem Arifin për veprën penale *"Mashtrim me*

subvencione" dhe kishte dënuar atë me burgim në kohëzgjatje prej 2 viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohej me kusht që brenda afatit kohor prej 3 viteve ai nuk do kryente ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa më 28 mars 2019 dhe 20 gusht 2019, Gjykata e Apelit kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe të akuzuarin Etem Arifi e dënoi me 1 vit e 3 muaj burgim. Këto aktgjykime të Gjykatës së Apelit, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të elaboruara më lart, ishin vendime të formës së prerë. Aktgjykimin e fundit të Gjykatës së Apelit Etem Arifi e kishte pranuar më 9 nëntor 2019. Më 30 janar 2020, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga Etem Arifi.

239. Më 26 gusht 2019, Presidenti shpalli zgjedhjet për Kuvend, të cilat u caktuan për datën 6 tetor 2019. Më 27 gusht 2019, KQZ nxori vendimin për Caktimin e Afateve të Aktiviteteve Zgjedhore, ku parashihej që afati për aplikim për certifikim i subjekteve politike dhe kandidateve fillon më 27 gusht 2019 dhe përfundon më 6 shtator 2019, ndërsa afati i fundit për tërheqjen e kandidatëve nga shorti i fletëvotimeve dha afati për zëvendësimin e kandidatëve ishte 8 - 17 shtator 2019.

240. Gjykata vëren se në kohën e certifikimit të kandidatëve dhe listave të subjekteve politike për zgjedhje, Etem Arifi ishte i dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit.

241. Më 27 nëntor 2019, KQZ certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend. Në listën e deputetëve të certifikuar nga KQZ ishte përfshirë edhe Etem Arifi, i cili tani më kishte pranuar Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit.

242. Më 26 dhjetor 2019, Kuvendi formoi Komisionin e Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve. Ky Komision paraqiti Raportin e tij për verifikimin e mandateve para Kuvendit, bazuar ekskluzivisht në Vendimin e KQZ-së, nr. 1845/2019, të datës 27 nëntor 2019, për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 6 tetor 2019, së bashku me listën përfundimtare të deputetëve, ku përfshihej edhe Etem Arifi. Në Raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve nuk vihej në dukje fakti se Etem Arifi ishte i dënuar për vepër penale me burgim prej një viti e tre muajsh.

243. Më 30 prill 2020, Kryetarja e Kuvendit pranoi një shkresë (Memorandumin sqarues) nga mbrojtësi ligjor i Etem Arifit, në lidhje me mandatin e këtij të fundit, ku ndër të tjera theksohet se "*mandati*

i z. Etem Arifi [...] është i ligjshëm dhe në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës pasi që i njëjti nuk është dënuar me vendim të plotfuqishëm nga gjykata gjatë këtij mandati (Legjislaturës VII) [...]".

244. Më 30 prill 2020, Kryetarja e Kuvendit kërkoi nga KGJK që të dërgojë në Kuvend të gjitha informatat dhe dokumentet lidhur me rastin në fjalë. Më 1 maj 2020, KGJK dorëzoi në Kuvend kopjet e aktgjykimeve me cilat Etem Arifi ishte shpallur fajtor për vepër penale.

245. Për sa i përket përgjigjes së KGJK-së, Gjykata dëshiron të theksojë faktin se, siç mund të konstatohet nga shkresat e lëndës si dhe nga informatat e paraqitura në seancën dëgjimore, KGJK-ja ka informuar Kuvendin se Etem Arifi është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë vetëm pasi Kryetarja e Kuvendit i ishte drejtuar KGJK-së duke i kërkuar informacion lidhur me rastin në fjalë. Në fakt, nëse merret për bazë momenti kohor kur Etem Arifi ishte dënuar për herë të parë me aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit (28 mars 2019), rezulton se Kuvendi është njoftuar në rrugë zyrtare nga KGJK-ja për dënimin e Etem Arifit pas më shumë se një viti.

246. Më 4 maj 2020, Kryetarja e Kuvendit i është drejtuar me shkresë Kryetarit të Komisionit për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, duke kërkuar që të trajtohet çështja e mandatit të Etem Arifit.

247. Më 12 maj 2020, Komisioni për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, dorëzoi përgjigjen në kërkesën e Kryetares së Kuvendit, duke sqaruar se "*[...] asnjë dispozitë e Rregullores së Kuvendit nuk flet për rastet kur deputeti e humb mandatin Ipso jure, përveç në rastin siç përcaktohet me nenin 70, paragrafi 3, nënparagrafi 5 i Kushtetutës, së Republikës së Kosovës dhe nenin 25 paragrafi 1 pika (e) e Rregullores së Kuvendit [...]*". Në fund, ky Komision rekomandoi *"që të ndiqen praktikat e mëparshme të Kuvendit"*.

248. Në ndërlidhje me përgjigjen e Komisioni për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, Gjykata vëren se, sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës (Shtojca nr. 2), Komisioni në fjalë *"shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e Rregullores së Kuvendit, për mandate dhe për imunitete"*. Më tutje, kjo Rregullore ngarkon këtë Komision, ndër të tjera, që të bëjë *"interpretimin e Rregullores së Kuvendit, kur kërkohet nga Kuvendi"*, si dhe *"shqyrtimin e kërkesave për heqjen e imunitetit dhe të mandatit të deputetëve dhe ia paraqet rekomandimet Kuvendit"*.

249. Gjykata vëren se megjithëse Rregullorja e Kuvendit e ngarkon Komisionin për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, me detyrën e shqyrtimit të kërkesave për heqjen e imunitetit dhe të mandatit të deputetëve, ajo nuk përcakton në mënyrë të qartë rolin e këtij Komisioni në rastin e humbjes së mandatit, apo pavlefshmërisë së një mandati të deputetit, për shkak të dënimit me burgim me vendim gjyqësor të formës së prerë (sipas nenit 70.3.6 të Kushtetutës, nenit 112.1.a të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenit 25.1.d. të Rregullores së Kuvendit).

250. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se Komisioni në fjalë është mjaftuar duke ndjekur një qasje të ngushtë në interpretimin e mandatit të tij, duke shmangur dhënien e një interpretimi gjithëpërfshirës të kornizës normative lidhur me mandatin e deputetëve në situatat kur një deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës vazhdon të ushtrojë mandatin e deputetit, pavarësisht se ka një dënim gjyqësor të formës së prerë me të cilin ai është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej më tepër së një vit. Dënim ky i cili është shqiptuar para se deputeti në fjalë të fitonte ulësen e deputetit, por i cili vazhdon të mbetet aktiv, si sanksion penal në pritje për ekzekutimin e tij. Pra, ky Komisioni nuk ishte në gjendje për të shprehur qëndrimin e tij të qartë se a kishte Etem Arifi mandat të vlefshëm të deputetit dhe, rrjedhimisht, a duhej të bëhej zëvendësimi i tij.

251. Gjykata vëren se, pas përgjigjes së Komisionit për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, as Kryetarja e Kuvendit dhe as ndonjë instancë tjetër nuk ka ndërmarr ndonjë veprim të mëtejmë për të sqaruar çështjen e vlefshmërisë së mandatit të Etem Arifit, si dhe për të bërë zëvendësimin eventual të tij.

252. Në këtë rrjedhë të ngjarjeve, më 3 qershor 2020, Kuvendi përmes vendimit të kontestuar, me 61 vota "për", 24 "kundër" dhe 1 abstenim, zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës. Sipas materialit të dorëzuar në Gjykatë, Etem Arifi ishte njëri nga deputetët që mori pjesë në procedurën e votimit duke votuar "për" zgjedhjen e Qeverisë.

253. Mbi bazën e këtyre fakteve kronologjike, rezulton që në ditën e votimit të vendimit të kontestuar në Kuvend, Etem Arifi:

a. ishte i dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit me burgim efektiv prej një viti e tre muaj, dënim ky që nuk ishte ekzekutuar ende;
b. ishte nxjerr vendimi i Gjykatës Supreme me të cilin atij i ishte konfirmuar dënimi;

c. kishte pranuar vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit dhe vendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme; *dhe*
d. Kuvendi po ashtu ishte i njoftuar nga KGJK lidhur me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit dhe atë të Gjykatës Supreme.

254. Në dritën e këtyre rrethanave faktike, Gjykata vëren interpretimet e ndryshme dhe kundërthënëse nga trupa të ndryshme të Kuvendit, si dhe nga palë të përfshira në këtë rast, lidhur me atë se "kur mandati i Etem Arifit është bërë i pavlefshëm". Kështu, Gjykata sjellë në vëmendje argumentimin e dhënë nga Drejtoria për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit të Kuvendit, në Opinionin për çështjen e mandatit të deputetit Etem Arifi, të 18 majit 2020, ku theksohej se: *"Vendimi gjyqësor ka marrë formën e prerë para se z. Etem Arifi të certifikohet si deputet i legjislaturës se VII-të. Në këtë rast nuk gjejnë zbatim dispozitat kushtetuese dhe ligjore, që lidhen me rolin e Kuvendit të Kosovës për marrjen e mandatit te deputetit. Bazuar ne Ligj in nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, [KQZ] është organ kompetent lidhur me verifikimin e kritereve formale që duhet të plotësojnë kandidatet për deputetet para certifikimit të tyre."*

255. Në këtë vijë argumentimi, Gjykata gjithashtu sjellë në vëmendje argumentimin e dhënë nga përfaqësuesi i Etem Arifit, në "Memorandumin sqarues" që ai i ka paraqitur Kryetares së Kuvendit më 20 prill 2020. Të njëjtën parashtresë përfaqësuesi i Etem Arifit e dorëzoi në Gjykatë më 7 dhjetor 2020, ku gjithashtu informoi Gjykatën se para gjykatave të rregullta kanë bërë kërkesë për rihapjen e rastit penal ndaj Etem Arifit. Në "Memorandumin sqarues" të lartcekur, përfaqësuesi i Etem Arifit arsyetoi se: "*mandati i z. Etem Arifi [...] është i ligjshëm dhe në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës pasi që i njëjti nuk është dënuar me vendim të plotfuqishëm nga gjykata gjatë këtij mandati (Legjislaturës VII) ndërsa dënimi i shqiptuar sipas Aktgjykimit 20.08.202 nuk ka paraqitur pengesë në certifikimin e z. Arifi si kandidat për deputet dhe po ashtu nuk paraqet pengesë ligjore në vazhdimin e ushtrimit të mandatit derisa ekzistojnë këto kushte ligjore*".

256. Lidhur me këtë çështje, Gjykata e konsideron të rëndësishme të sjellë në vëmendje se edhe gjatë seancës dëgjimore palët kanë shprehur qëndrime të kundërta përkitazi me pyetjen se a e ka humbur dhe, nëse po, kur e ka humbur Etem Arifi mandatin e tij. Kështu, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës pretendoi se Etem Arifi e ka fituar mandatin në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin dhe se humbja e mandatit të tij ka filluar të prodhojë efekt për Kuvendin nga momentin kur

Kuvendi është njoftuar nga KGJK-ja për dënimin e deputetit në fjalë. Përfaqësuesi i Kryetares së Kuvendit u shpreh se Etem Arifi vazhdon të ketë mandat. Ndërsa përfaqësuesi i Qeverisë argumentoi se Etem Arifi ka humbur mandatin në legjislaturën e kaluar (kur edhe është dënuar me vendim të formës së prerë) dhe, sipas tij, mandati i Etem Arifi në këtë legjislaturë është i vlefshëm.

257. Në lidhje me këtë, Gjykata potencon fillimisht se në kohën e shqiptimit të dënimit nga Gjykata e Apelit, më 19 mars dhe 20 gusht 2019, Etem Arifi ishte deputet i legjislaturës së kaluar të Kuvendit (gjegjësisht legjislaturës së VI-të), e cila legjislaturë u shpërbë pas votimit të Kuvendit më 22 gusht 2020. Në bazë të përgjigjes së pranuar nga Sekretaria e Kuvendit, nuk rezulton se Etem Arifi ishte zëvendësuar në legjislaturën e kaluar (legjislaturës së VI-të), duke qenë se Kuvendi nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim lidhur me mandatin e Etem Arifit.

258. Megjithatë, Gjykata thekson se – përtej çështjes që ngrihet lidhur me mundësinë e humbjes së mandatit të deputetit si pasojë e dënimit për vepër penale gjatë një legjislature të caktuar – Kushtetuta dhe ligjet përkatëse nuk lejojnë që personi i dënuar për vepër penale as të kandidojë në zgjedhje (nëse ka qenë i dënuar për vepër penale gjatë tri viteve të fundit) e as të ushtrojë detyrën e deputetit (nëse me vendim gjyqësor të formës së prerë është dënuar me një apo më tepër vite burgim).

259. Pra, Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk është qenësore se a është dashur t'i merret Etem Arifit mandati i deputetit, në legjislaturën e kaluar, në bazë të nenit 70.3.6 të Kushtetutës, por pikë së pari a është dashur të lejohet kandidimi i tij për deputet, në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, sipas nenit 71.1 të Kushtetutës dhe nenit 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

260. Në vlerësimin e Gjykatës, neni 70.3.6 i Kushtetutës, neni 8.1.6 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe nenin 112.1 (a) dhe (c) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, duhet të lexohen në mënyrë të ndërthurur me nenin 71.1 të Kushtetutës dhe nenit 29.1.q të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Qëllimi i përbashkët i këtyre neneve kushtetuese dhe ligjore është që:

1. personat e dënuar për vepra penale me vendime gjyqësore të formës së prerë, të vlefshme në Republikën e Kosovës, të mos mund të kandidohen e as të zgjidhen si deputet, nëse janë dënuar gjatë tri viteve të fundit para zgjedhjeve; dhe
2. të mos mund të ushtrojnë mandatin e deputetit nëse janë të dënuar me një apo më tepër vite burgim, me një vendim

gjyqësor të formës së prerë, të vlefshëm në Republikën e Kosovës.

261. Si të tilla, dispozita e lartcekura kushtetuese dhe ligjore janë të ndërlidhura dhe përplotësuese. Në një vështrim të përgjithshëm, ato dispozita shpërfaqin qëllimin e qartë të ligjbërësit që personat e dënuar penalisht për shkelje të ligjit të mos mund të zgjedhën deputet për një periudhë të caktuar kohore, si dhe të mos mund të ushtrojnë detyrën e përfaqësuesit të qytetarëve në organin ligjdhënës të vendit – Kuvendin e Republikës së Kosovës.

262. Gjykata konsideron se një qasje e tillë, për sa i përket efektit të dënimit në mandatin e deputetit, përvijohet edhe në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO98/11, ku Gjykata ka potencuar se mandati i deputetit mbaron kur ***"ekziston"*** vendimi gjyqësor i formës së prerë më të cilin një deputet dënohet me një ose më shumë vjet burgim. Ky është një interpretim i arsyeshëm, duke qenë se dënimi me burgim efektiv, në një kohëzgjatje të caktuar, ia pamundëson deputetit ushtrimin e funksionit të tij përfaqësues. Rrjedhimisht, kjo pamundëson përfaqësimin e zgjedhësve që kanë votuar për deputetin në fjalë dhe, për më tepër, cenon integritetin e organit legjislativ.

263. Kjo është në përputhje edhe me praktikën e shumicës dërmuese të shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, si dhe me qëndrimet e shprehura në Raportet e Komisionit të Venecias.

264. Në këtë prizëm, Komisioni i Venecia i referohet praktikës së GJEDNJ-së e cila vë në pah se, sipas nenit 3 të Protokollit 1 të KEDNJ, "*kufizimet në të drejtën për t'u zgjedhur duhet të kufizohen në atë çfarë është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur dhe ruajtjen e qeverisjes demokratike. Ky funksionim do rrezikohej më seriozisht nga një zyrtar i zgjedhur, sesa nga një votues. Kufizimet në fjalë nuk duhet të konsiderohen si kufizim i demokracisë por si ruajtje e saj*" (shih Raportin e Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave të Paligjshme nga Parlamenti, faqe 28).

265. Në anën tjetër, Gjykata dëshiron të sqarojë se e konsideron të paqëndrueshëm argumentin e parashtruesve të kërkesës se efekti kushtetues i dënimit të Etem Arifit fillon të rrjedhë nga momenti kur Kuvendi është informuar nga KGJK-ja për ekzistimin e këtij dënimi. Kjo për shkak se as Kushtetuta e as ndonjë dispozitë ligjore nuk përcakton një procedurë që duhet ndjekur për t'iu marrë mandati një deputeti – pasi ai të ketë humbur mandatin si pasojë e dënimit për vepër penale. Si dhe për shkak të mungesës së ndonjë baze të qartë normative që përcakton se si dhe kur KGJK-ja (apo gjykatat) kanë për

detyrim të informojnë Kuvendin që një deputet është i dënuar për vepër penale.

266. Pra, siç shihet nga shkresat e lëndës dhe siç është theksuar edhe nga përfaqësuesi i KGJK-së gjatë seancës dëgjimore, nuk ekziston asnjë dispozitë normative (akt ligjor apo nënligjor), që përcakton detyrim të qartë për KGJK-në për të informuar Kuvendin për dënimin e deputetëve. Si pasojë e kësaj, në rastin konkret Kuvendi është informuar nga KGJK-ja për dënimin e Etem Arifit vetëm pasi që Kryetarja e Kuvendit ka kërkuar zyrtarisht nga KGJK-ja që ta informojë për këtë rast dhe pothuajse pas një viti pas dënimit (për herë të parë) të tij, me vendim të formës së prerë.

267. Për sa më sipër, duke u mbështetur mbi parimet dhe konstatimet e shtjelluara më lart, Gjykata vlerëson se Etem Arifi nuk e ka fituar mandatin e deputetit në përputhje me nenin 71.1 të Kushtetutës dhe nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe as nuk mund të ushtrojë atë, sipas nenit 70.3.6 të Kushtetutës, në ndërlidhje me neni 8.1.6 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe nenin 112.1 (a) dhe (c) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

268. Në rrethana të tilla, Gjykata nuk mund të veshë me legjitimet kushtetues mandatin e një deputeti, për të cilin është konfirmuar se nuk ishin plotësuar kushtet e parapara me Kushtetutë dhe ligje përkatëse, as për të qenë kandidat për deputet (kur është kandiduar dhe zgjedhur), e as për të ushtruar mandatin e deputetit.

269. Prandaj, Gjykata konstaton se me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar, Etem Arifi nuk kishte mandat të vlefshëm të deputetit, konform neneve 71.1 dhe 70.3.6 të Kushtetutës, nenit 8.1.6 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe neneve 29.1(q) dhe 112.1.a të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

II. A është në pajtueshmëri me Kushtetutën vendim i kontestuar i Kuvendit nëse në procedurën e votimit të tij ka marrë pjesë një deputet i cili nuk kishte mandat të vlefshëm?

270. Pasi Gjykata konstatoi se me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar Etem Arifi nuk kishte mandat të vlefshëm të deputetit, sipas dispozitave gjegjëse kushtetuese dhe ligjore të shtjelluara më lartë, në vazhdim do të vlerësojë nëse procedura për nxjerrjen e Vendimit të kontestuar ishte në pajtim me Kushtetutën.

271. Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës që përcakton se:

> *"3. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës".*

272. Gjykata thekson se sipas dispozitave të lartcekura të Kushtetutës në mënyrë që të zgjidhet Qeveria kërkohet që shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të votojnë *"për"* Qeverinë e propozuar. Duke pasur parasysh që Kuvendi i Kosovës, sipas nenit 164, paragrafi 1 të Kushtetutës, i ka 120 deputetë, Gjykata vëren se të paktën 61 deputetë duhet të votojnë *"për"* Qeverinë, në mënyrë që ajo të konsiderohet e zgjedhur.

273. Gjykata vë në dukje se ky interpretim i kuptimit të "shumicës së deputeteve të Kuvendit" është interpretuar nga Gjykata Kushtetuese edhe në Aktgjykimin KO72/20. Në atë rast, Gjykata kishte konstatuar në mënyrë të qartë se *"Neni 95 i Kushtetutës është i organizuar në 6 paragrafë, të cilët përcaktojnë mënyrën e zgjedhjes së Qeverisë në kuadër të një cikli zgjedhor, [...] Paragrafi i dytë dhe i tretë i tij [nenit 95 të Kushtetutës], përcaktojnë [...] se Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, përkatësisht votën e gjashtëdhjetë e një (61) deputetëve", (*shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO72/20, parashtrues: *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,* Aktgjykimit i 28 majit 2020, publikuar më 1 qershor 2020, paragrafi 428).

274. Më tutje, në të njëjtin Aktgjykim, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se "*Për miratimin e mosbesimit ndaj një Qeverie, mjaftojnë gjashtëdhjetë e një (61) vota të përfaqësuesve të popullit, aq sa mjaftojnë edhe për t'i dhënë besimin e Kuvendit një Qeverie për tu konsideruar e zgjedhur*," (shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO72/20, paragrafi 388).

275. Një interpretim i tillë konfirmohet edhe nga përgjigjet e marra nga shtetet e Forumit të Komisionit të Venecias, ku nga të gjitha shtetet të cilat parashohin votimin e *"shumicës së të gjithë deputeteve të Parlamentit"* është sqaruar që shumica e të gjithë deputetëve të Parlamentit nënkupton shumicën e numrit të deputetëve të paraparë me kushtetutat e tyre.

276. Gjykata vëren se, në rastin e Kosovës, kjo shumicë, pra *"shumica e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës*", dallon nga shumica e votave deputetëve që kërkohet për të marrë vendime të tjera

në Kuvend. Në këtë aspekt, Kushtetuta e Kosovës bënë dallim në mes të procedurave vendimmarrëse ku për marrjen e vendimit kërkohet shumica e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit (për disa vendime shumë të rëndësishme), me procedurat vendimmarrëse kur kërkohet shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.

277. Rrjedhimisht, Gjykata rithekson edhe njëherë se në mënyrë që Qeveria të zgjidhet, konform paragrafit 3 të nenit 95 të Kushtetutës, "për" Qeverinë duhet të votojnë të paktë gjashtëdhjetë e një (61) deputetë të Kuvendit.

278. Në rastin konkret, sipas dokumenteve zyrtare të Kuvendit, Gjykata vëren se më 3 qershor 2020, gjashtëdhjetë e një (61) deputetë kishin votuar *"për"* Qeverinë, gjegjësisht për vendimin e kontestuar. Për miratimin e vendimit të kontestuar kishte votuar edhe Etem Arifi.

279. Gjykata konstatoi më sipër se mandati i Etem Arifit kishte qenë i pavlefshëm para votimit të vendimit të kontestuar. Andaj, duke qenë se vendimi i kontestuar kishte marrë vetëm 61 vota të deputetëve të Kuvendit, duke përfshirë edhe votën e Etem Arifit, Gjykata thekson se pa numëruar votën e tij, vendimi i kontestuar kishte marrë vetëm 60 vota të deputetëve të Kuvendit.

280. Më tutje, Gjykata e konsideron të rëndësishme të vë theksin në nenin 70 [Mandatet e Deputeteve] të Kushtetutës, i cili thekson se *"Deputetet e Kuvendit janë përfaqësues të popullit"*. Ndërsa neni 74 [Ushtrimi i funksionit] i Kushtetutës përcakton se: *"deputetet e Kuvendit të Kosovës do të ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe sipas Kushtetutës, ligjeve dhe rregullat e procedurës së Kuvendi"*.

281. Gjykata konstaton se Vendimi nr. 07/V-014, i 3 qershorit 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën, sepse ai vendim nuk ka marr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht 61 vota të vlefshme, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 95 të Kushtetutës.

282. Gjykata rithekson se në mënyrë që Qeveria të zgjidhet, konform paragrafit 3 të nenit 95 të Kushtetutës, "për" Qeverinë duhet të votojnë të paktën gjashtëdhjetë e një (61) deputetë të Kuvendit. Në rastin konkret, sipas dokumenteve zyrtare të Kuvendit, Gjykata vëren se më 3 qershor 2020, gjashtëdhjetë e një (61) deputetë kishin votuar *"për"* Qeverinë, gjegjësisht për Vendimin e kontestuar. Për miratimin e Vendimit të kontestuar kishte votuar edhe Etem Arifi. Pasi Gjykata

gjeti se mandati i Etem Arifit kishte qenë i pavlefshëm para votimit të Vendimit të kontestuar, ai Vendim kishte marrë vetëm gjashtëdhjetë (60) vota të vlefshme.

283. Më tutje, përkitazi me efektet e këtij Aktgjykimi, Gjykata e konsideron të nevojshme të sqarojë se neni 95 i Kushtetutës, siç është interpretuar përmes praktikës së saj gjyqësore, parasheh dy tentativa për të zgjedhur Qeverinë nga Kuvendi. Në të dyja rastet, Qeveria për t'u konsideruar e zgjedhur duhet të këtë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht gjashtëdhjetë e një (61) vota. Nëse as pas tentimit të dytë nuk zgjidhet Qeveria, neni 95.4 i Kushtetutës shprehimisht përcakton shpalljen e zgjedhjeve nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës e të cilat, bazuar në këtë nen, duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre nga ana e Presidentit.

284. Gjykata rikujton që Qeveria e votuar përmes Vendimit nr. 07/V-014 të Kuvendit, të 3 qershorit 2020, është bazuar në Dekretin e Presidentit nr. 24/2020, të nxjerrë bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, përkatësisht në tentativën e dytë për zgjedhjen e Qeverisë. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton interpretimin e dhënë në Aktgjykimin KO72/20 ku kishte theksuar se *"zgjedhjet do të jenë të pa evitueshme në rast të dështimit të zgjedhjes së Qeverisë edhe në tentativën e dytë, [...] me ç'rast, bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, Presidenti shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre".*

285. Prandaj, Gjykata rithekson se kur një Qeveri e propozuar bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, nuk i merr votat e nevojshme për t'u zgjedhur, Kushtetuta në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se Presidenti i Republikës së Kosovës shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.

286. Në fund, Gjykata gjithashtu sqaron se konstatimi që Vendimi i kontestuar i Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë nuk është në përputhshmëri me paragrafin 3 të nenit 95 të Kushtetutës, nuk rezulton në shpërndarjen automatike të Kuvendit.

Përfundime

287. Me datat 28 mars dhe 20 gusht 2019, Etem Arifi ishte dënuar me Aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, me një vit e tre muaj burgim. Më 6 tetor 2019, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Etem Arifi kandidoi dhe u zgjodh deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Më 27 nëntor 2019, KQZ certifikoi rezultatin e zgjedhjeve dhe në listën e deputetëve të

certifikuar ishte edhe Etem Arifi. Më 26 dhjetor 2019, u mbajt mbledhja konstituive e Kuvendit ku u konfirmua mandati i Etem Arifit. Që nga ajo kohë, Etem Arifi vazhdoi të ushtronte funksionin e deputetit, edhe pse ndaj tij rëndonte një dënim gjyqësor i formës së prerë, për një vepër penale, me një vit e tre muaj burgim.

288. Në këtë kërkesë kushtetuese, 17 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestuan kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, për zgjedhjen e Qeverisë, të nxjerrë me 3 qershor 2020. Parashtruesit pretendojnë se Vendimi në fjalë është në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë], në lidhje me nënparagrafin 6 të paragrafit 3 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës. Kjo sepse, sipas parashtruesve, në procedurën e votimit të Vendimit të kontestuar ka marrë pjesë edhe Etem Arifi, vota e të cilit ishte e pavlefshme për shkak të dënimit të tij me një vit e tre muaj burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

289. Gjykata vlerëson se çështja themelore që ngërthen kjo kërkesë është se a kishte pasur mandat të vlefshëm Etem Arifi në kohën e nxjerrjes në Kuvend të Vendimit të kontestuar për zgjedhjen e Qeverisë (në votimin e të cilit ai kishte marrë pjesë).

290. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata mori parasysh: përgjigjet e dorëzuara nga shtetet anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, qëndrimet e Komisionit të Venecias; si dhe praktikën e mëhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për situata të ngjashme.

291. Për sa i përket dispozitave kushtetuese dhe ligjore në Republikën e Kosovës, që i japin përgjigje çështjeve të ngritura nga kjo kërkesë, Gjykata gjeti se:

e. Neni 71.1 i Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 29.1(q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcakton se asnjë person nuk mund të jetë kandidat për deputet për zgjedhjet për Kuvend nëse është dënuar për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë në tri vitet e fundit;

f. neni 70.3 (6) i Kushtetutës përcakton se mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm nëse ai/ajo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, me një ose më shumë vite burgim. Ky përcaktim kushtetues përforcohet edhe me nenin 8.1.6 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, nenin 112.1.a të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenin 25.1.d të Rregullores së Kuvendit;

292. Gjykata konsideron se, për sa i përket të drejtës për kandidim në zgjedhje parlamentare, nenet 45, 55 dhe 71.1 të Kushtetutës duhet lexuar në mënyrë të ndërlidhur. Kështu, neni 45 i Kushtetutës flet përgjithësisht për të drejtat zgjedhore, duke përcaktuar në mënyrë të përgjithësuar se ato mund të kufizohen me vendime gjyqësore, kurse neni 55 përcakton kushtet kumulative në bazë të të cilave mund të kufizohen të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë. Ndërsa neni 71 i Kushtetutës – i cili flet ekskluzivisht për "kualifikimet" për të kandiduar për deputet të Kuvendit – përcakton se secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë vjeç ose më i madh dhe <u>përmbush kriteret ligjore</u>, mund të jetë kandidat për deputet. Këto "kriteret ligjore", të cilave iu referohet neni 71 i Kushtetutës, i përcakton Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili në nenin 29.1 (q) thekson qartë dhe shprehimisht se asnjë person nuk mund të jetë kandidat për deputet për zgjedhje për Kuvend, nëse është dënuar për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë në tri vitet e fundit. Ky përcaktim kushtetues dhe ligjor është në linjë edhe me praktikën që ndiqet nga shumë vende demokratike, siç vërehet edhe nga dokumentet përkatëse të Komisionit të Venecias, si dhe nga përgjigjet e vendeve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias.

293. Gjykata thekson se normat e mësipërme kushtetuese dhe ligjore, të cilat kanë të bëjnë me pamundësinë (papërshtatshmërinë) për t'u kandiduar për deputet në zgjedhjet e përgjithshme, si dhe me mbarimin apo pavlefshmërinë e mandatit të deputetit, si pasojë e dënimit me burgim për kryerjen e veprave penale, nuk duhen parë si qëllim në vetvete. Në thelb, këto norma nuk kanë synim parësor ndëshkimin e individëve të caktuar duke ua pamundësuar atyre ushtrimin e funksionit të deputetit, por kanë si qëllim themelor mbrojtjen e integritetit kushtetues dhe besueshmërisë qytetare në organin ligjdhënës, si shtyllë e demokracisë parlamentare.

294. Gjykata konsideron se besueshmëria qytetare në Kuvendin e Republikës së Kosovës cenohet nëse – pavarësisht ndalesave që vë neni 71 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – lejohet që mandatin e deputetit ta fitojë dhe ta ushtrojë një person që është dënuar për vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë të vlefshëm në Republikën e Kosovës.

295. Në lidhje me këtë, Gjykata sjellë në vëmendje Raportin e Komisionit të Venecias, i cili thekson se *"ligjshmëria është element i Sundimit të Ligjit dhe nënkupton që ligji duhet të respektohet nga individët dhe autoritetet. Ushtrimi i funksionit politik nga personat të cilët kanë*

shkelur ligjin në mënyrë serioze vendos në rrezik zbatimin e këtij parimit [sundimit të ligjit], që është njëri nga parakushtet e demokracisë, dhe për këtë arsye rrezikon natyrën demokratike të shtetit" (Shih Raportin e Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave të Paligjshme nga Parlamenti, CDL-AD(2015)036, i 23 nëntorit 2018, paragrafi 168).

296. Në këtë frymë, Gjykata vlerëson se është kërkesë e qartë kushtetuese e mishëruar në nenin 71.1 në ndërlidhje me nenin 70.3 (6) të Kushtetutës, se është e papajtueshme me Kushtetutën që një person ta fitojë dhe ta mbajë mandatin e deputetit nëse është i dënuar për vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë, siç është përcaktuar me këto dispozita. Kjo kërkesë përforcohet me nenet 29 dhe 112 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenin 8.1.6 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë Deputetit.

297. Më tutje, Gjykata thekson se fakti që neni 70.3 (6) i Kushtetutës, neni 8.1.6 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe neni 112.1 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i referohen dënimit të deputetit (pra dënimit pasi ai ta ketë fituar mandatin), është reflektim i prezumimit se neni 29.1 (q) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili mbështetet në nenin 71.1 të Kushtetutës, nuk lejon që një person i dënuar me burgim gjatë tri viteve të fundit para zgjedhjeve të kandidojë për deputet dhe të fitoj mandatin e deputetit.

298. Rrjedhimisht, duke u bazuar në gjuhën e qartë të nenit 71.1 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nënparagrafit 6 të paragrafit 3 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata konsideron se asnjë person nuk mund të fitojë dhe mbajë mandat të vlefshëm të deputetit nëse është i dënuar për vepër penale sikurse parashihet me këto dispozita, me vendim gjyqësor të formës së prerë, nëse kundër tij/saj ka një vendim dënues që është në fuqi në Republikën e Kosovës.

299. Gjykata vëren sqarimin e KQZ-së se sipas Aktgjykimit AA.-Uzh.nr.16/2017, të 19 shtatorit 2017 të Gjykatës Supreme, *"askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje, nëse një e drejtë e tillë nuk i është hequr me vendim gjyqësor, e që don të thotë, se kandidati duhet me vendim të formës së prerë, të shpallet fajtor dhe gjykata, t'i ketë shqiptuar dënimin plotësues "heqjen e të drejtës për tu zgjedhur"*.

300. Megjithatë, Gjykata konsideron se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk kërkon që personave të dënuar për vepra penale t'iu shqiptohet medoemos si dënim plotësues *"heqja e të drejtës për t'u zgjedhur"*, në

mënyrë që ata të mos lejohen të kandidojnë në zgjedhje parlamentare. Kjo meqë, sipas nenit 29.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ndër të tjera, parashihen edhe këto dy baza: (i) heqja e të drejtës për të qenë kandidat në zgjedhje me vendim të PZAP-it dhe gjykatës; si dhe (ii) pamundësia për të qenë kandidat për shkak të shpalljes fajtor për një vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit. Këto janë baza të ndryshme/të ndara që shkaktojnë pamundësinë/papërshtatshmërinë për të qenë kandidat. Gjykata është e mendimit se ky interpretim përputhet edhe me leximin e ndërlidhur të neneve 45, 55 dhe 71 të Kushtetutës.

301. Gjykata konsideron të rëndësishme të vë në dukje se kandidimi në zgjedhje parlamentare i Etem Arifit, zgjedhja e tij si deputet dhe ushtrimi i mandatit të deputetit – të gjitha këto pasi që ai ishte dënuar me një vit e tre muaj burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë – shpërfaqin ekzistimin e paqartësisë normative dhe të metave serioze në mekanizmat institucionalë të Republikës së Kosovës, që janë kompetent për të garantuar ligjshmërinë dhe integritetin kushtetues të proceseve zgjedhore dhe veprimtarisë parlamentare. Kjo paqartësi është e dukshme edhe në përgjigjet që janë dhënë nga trupat përkatës të Kuvendit dhe nga KQZ-ja.

302. Në lidhje me këtë, Gjykata potencon nevojën që Kuvendi i Republikës së Kosovës me komisionet e tij, në bashkëveprim me institucionet gjegjëse, duke përfshirë edhe KGJK-në dhe KQZ-në, të qartësojnë dhe konsolidojnë bashkëpunimin ndër-institucional dhe aspektet normative që kanë të bëjnë me kandidimin në zgjedhje parlamentare dhe ushtrimin e mandatit të deputetit, nga ana e personave të dënuar për vepra penale.

303. Kjo është e domosdoshme për të shmangur situatat paradoksale, nga këndvështrimi kushtetues, ku një person, pasi është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë sikurse parashihet me nenet përkatëse të Kushtetutës dhe ligjeve, i lejohet të kandidojë në zgjedhje parlamentare, të zgjidhet deputet, t'i verifikohet mandati, si dhe të vazhdojë të ushtrojë funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, madje edhe gjatë vuajtjes së dënimit me burgim. Ndërkohë që Kushtetuta dhe ligjet përkatëse vënë barriera të qarta normative për të mos lejuar personat e dënuar me burgim për kryerjen e veprave penale, që të zgjedhën deputet dhe të ushtrojnë mandatin e deputetit.

304. Për sa i përket zgjedhjes së Qeverisë, Gjykata thekson se në mënyrë që Qeveria të zgjidhet, konform paragrafit 3 të nenit 95 të Kushtetutës, "për" Qeverinë duhet të votojnë të paktën gjashtëdhjetë e një (61)

deputetë të Kuvendit. Në rastin konkret, sipas dokumenteve zyrtare të Kuvendit, Gjykata vëren se më 3 qershor 2020, gjashtëdhjetë e një (61) deputetë kishin votuar *"për"* Qeverinë, gjegjësisht për vendimin e kontestuar. Për miratimin e Vendimit të kontestuar kishte votuar edhe Etem Arifi. Pasi Gjykata gjeti se mandati i Etem Arifit kishte qenë i pavlefshëm para votimit të Vendimit të kontestuar, ai Vendim kishte marrë vetëm gjashtëdhjetë (60) vota të vlefshme. Për pasojë, procedura për të zgjedhur Qeverinë nuk është zhvilluar në përputhje me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, sepse Qeveria nuk ka marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

305. Gjykata vë në pah se neni 95 i Kushtetutës, siç është interpretuar përmes praktikës së saj gjyqësore, parasheh dy tentativa për të zgjedhur Qeverinë nga Kuvendi. Në të dyja rastet, Qeveria për t'u konsideruar e zgjedhur duhet të këtë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht gjashtëdhjetë e një (61) vota. Nëse as pas tentimit të dytë nuk zgjidhet Qeveria, neni 95.4 i Kushtetutës parasheh shpalljen e zgjedhjeve nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës.

306. Gjykata rikujton që Qeveria e votuar përmes Vendimit nr. 07/V-014 të Kuvendit, të 3 qershorit 2020, është bazuar në Dekretin e Presidentit nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020, të nxjerrë bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, përkatësisht në tentativën e dytë për zgjedhjen e Qeverisë. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton interpretimin e dhënë në Aktgjykimin KO72/20 ku kishte theksuar se *"zgjedhjet do të jenë të pa evitueshme në rast të dështimit të zgjedhjes së Qeverisë edhe në tentativën e dytë, [...] me ç'rast, bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, Presidenti shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre"*.

307. Në dritën e kësaj, Gjykata thekson se në rastin konkret vihet në lëvizje paragrafi 4 i nenit 95 të Kushtetutës, sipas të cilit Presidenti i Republikës së Kosovës shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.

308. Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksojë se është e vetëdijshme se Etem Arifi ka marrë pjesë edhe në procedura të tjera votuese në Kuvend, edhe pasi ai nuk kishte mandat të vlefshëm. Megjithatë, duke u mbështetur në parimin *non ultra petita* ("jo përtej kërkesës"), Gjykata kufizohet në vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar më kërkesën e paraqitur para saj, gjegjësisht

Vendimit nr. 07/V-014, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkitazi me Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

309. Gjykata e sheh të nevojshme që të sqarojë po ashtu se, duke u nisur nga parimi i sigurisë juridike, si dhe nga fakti se ky Aktgjykim nuk mund të ketë efekt prapaveprues, vendimet e Qeverisë aktuale mbeten në fuqi, si dhe Qeveria mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113, paragrafi 5, të Kushtetutës, neneve 42 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në mbështetje të rregullave 59 (1) dhe 74 të Rregullores së punës, më 21 dhjetor 2020, njëzëri

VENDOS

I. TË SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se, në bazë të nenit 71.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, në ndërlidhje me nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, personi i dënuar për vepër penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë në tri (3) vitet e fundit, nuk mund të jetë kandidat për deputet e as të fitojë mandat të vlefshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës;

III. TË KONSTATOJË se Vendimi nr. 07/V-014 i Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i 3 qershorit 2020, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, sepse Qeveria nuk ka marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

IV. TË KONSTATOJË se marrë parasysh se Qeveria nuk është zgjedhur sipas paragrafit 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, atëherë mbështetur në paragrafin 4 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, Presidenti i Republikës së Kosovës shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre;

V. TË KONSTATOJË se ky Aktgjykim nuk ka efekt prapaveprues dhe mbështetur në parimin e sigurisë juridike vendimet e Qeverisë mbeten në fuqi, si dhe Qeveria mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re;

VI. TË SHPALLË se ky Aktgjykim hyn në fuqi ditën e publikimit dhe dorëzimit të tij tek palët;

VII. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me
nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI230/19, Parashtruesi i kërkesës: Albert Rakipi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019

KI230/19, Aktgjykim, vendosur më 9 dhjetor 2020

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, kërkesë për mbajtje të seancës dëgjimore publike, kërkesë e pranueshme, parimi i kontradiktoritetit, parimi i barazisë së armëve, mungesë e vendimit të arsyetuar gjyqësor, person zyrtar, përdorimi i analogjisë në të drejtën penale, shkelje e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.*

1. Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me atë se parashtruesi i kërkesës, në vitin 2015 nga Prokuroria Speciale Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PSRK) u akuzua se në bashkëkryerje, si drejtor i një kompanie [kompania ISN] në Republikën e Shqipërisë kishte fituar kontratën me Universitetin e Prishtinës për përkthimin e disa librave, dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për kompaninë, kishte "falsifikuar kontratën origjinale", ku më pas ishte bërë edhe ndryshimi i kontratës, i cili i mundësoi kompanisë përfitim më të madh për sasinë e njëjtë të shërbimit. Më 18 dhjetor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktgjykimit PKR. nr. 432/15, pas konstatimit se parashtruesi i kërkesës e kishte statusin e personit zyrtar, e shpalli atë fajtor për kryerjen e veprës penale "mashtrim në detyrë " në bashkëkryerje nga neni 341, paragrafi 3 në lidhje me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, dhe për pasojë e gjykoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, duke ia zëvendësuar dënimin me burgim me dënim me gjobë në shumë prej 10,000 (dhjetëmijë) euro. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës, dy të dënuarit tjerë, si dhe PSRK kishin parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit. Parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike kishte pretenduar se (i) Gjykata Themelore në mënyrë të paligjshme kishte refuzuar administrimin e korrespodencës së një e-maili, të cilin ai e kishte propozuar si provë materiale (ii) se ai nuk e kishte statusin e personit zyrtar; dhe (iii) shkelje të dispozitave të procedurës penale për arsye se kërkesa pasurore juridike nuk ishte dorëzuar nga personi kompetent. Ndërsa PSRK, përmes ankesës së saj kishte kërkuar ndryshimin e vendimit mbi dënimin. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, përmes Aktgjykimit [PAKR nr. 27/2018] të 2 majit 2018 pjesërisht aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës vetëm përkitazi me kërkesën pasurore juridike, duke e udhëzuar Universitetin e Prishtinës në kontest civil për realizmin e kësaj kërkese, ndërsa në tërësi e aprovoi ankesën e PSRK-së duke e ndryshuar vendimin mbi dënimin, dhe rrjedhimisht parashtruesit të kërkesës i shqiptoi atij dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1)

viti. Si rezultat i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Supreme, përmes të cilës, ndër të tjera ai ishte ankuar për mosmbajtjen e seancës së Kolegjit të Apelit, dhe sipas tij atij i ishte mohuar prezantimi i provave të reja, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Pml. nr. 238/2018, të 5 tetorit 2018 e aprovoi si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, dhe e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe çështjen e ktheu për rivendosje në të njëjtën gjykatë. Në procedurë të rivendosjes, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 528/2018, të 16 prillit 2019 e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, të 18 dhjetorit 2017. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë kishte (i) pretenduar cenim të barazisë së armwve dhe parimit të kontradiktoritetit si rezultat i mosadministrimit të korrespodencës elektronike si provë materiale nga Gjykata Themelore; (ii) interpretim të gabuar të ligjit dhe shkeljes së parimit të ndalimit të analogjisë në të drejtën penale, si rezultat i cilësimit të tij si person zyrtar. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Pml. 253/2019, të 30 shtatorit 2019 e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimet e Gjykatës Themelore, të 18 dhjetorit 2017 dhe asaj të Apelit, të 16 prillit 2019. Gjykata Supreme vërtetoi qëndrimin e gjykatave të shkallës më të ulët përkitazi me mosparovimin e tyre për administrimin e korrespodencës elektronike si provë materiale dhe interpretimin e tyre përkitazi me cilësimin e parashtruesit të kërkesës si person zyrtar, i cili për pasojë ishte gjykuar për kryerjen e veprës penale mashtrim në detyrë.

2. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me konstatimet e lartcekura të gjykatave të rregullta, në mënyrë specifike asaj të Gjykatës Supreme pretendoi se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ). Parashtruesi i kërkesës, në thelb pretendoi shkelje të cenimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, si rezultat i mosadministrimit të korrespodencës elektronike si provë materiale dhe (ii) interpretim të gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta, të cilat sipas tij duke përdorë analogjinë, kishin gabimisht kishin interpretuar se ai e kishte statusin e personit zyrtar. Në vijim parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkoi mbajtjen e seancës dëgjimore publike në Gjykatë.

3. Gjykata gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës konstatoi se parashtruesi i kërkesës (i) është palë e autorizuar, sepse e dorëzoi kërkesën në cilësinë e individit me qëllim të mbrojtjes së të drejtave; (ii) ka saktësuar të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë për të cilat pretendon se i janë shkelur; (iii) ka dorëzuar kërkesën e tij brenda afatit; (iv) se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht konkludoi se kërkesa e parashtruesit është e pranueshme.

4. Gjykata, në vijim, përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta gjatë cilësimit të tij si person zyrtar, vendosi që këtë pretendim ta shqyrtojë në kuadër të së drejtës së tij për vendim të arsyetuar gjyqësore, e cila po ashtu është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

5. Gjykata, pas vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar edhe standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Gjykata përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atij të barazisë së armëve dhe mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, parime dhe garanci këto që janë të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së konstatoi si në vijim: (i) Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për cenim të parimit të *"barazisë së armëve"* dhe *"parimit të kontradiktoritetit"* si rezultat i mospranimit të provës së propozuar nga gjykatat e rregullta, Gjykata konstatoi se janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se atij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe (ii) sa i përket mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata konstatoi se me nxjerren e Aktgjykimit Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, Gjykata Supreme ka dështuar të arsyetoj pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj përkitazi me cilësimin e tij si person zyrtar.

htë garantuar partisë ose koalicionit fitues të zgjedhjeve përmes Kushtetutës. Ushtrimi i kësaj të drejte, nuk është i mveshur edhe me autorizimin për të bllokuar formimin e një Qeverie brenda një cikli zgjedhor. Një qëndrim i tillë, do t'i bënte peng të partisë ose koalicionit fitues, të gjitha institucionet më thelbësore të shtetit.

Gjykata në fund thekson se funksionimi demokratik i institucioneve është përgjegjësi parësore e secilit person i cili është i mveshur me autorizime publike. Të gjitha veprimet që ndërmerren nga personat e mveshur me fuqi ose autorizime publik duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për Republikën e Kosovës, ashtu që kjo i fundit të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar dhe aspiratave të mishëruara në Preambulën e saj.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI230/19

Parashtrues

Albert Rakipi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Albert Rakipi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), shtetas i Republikës së Shqipërisë, të cilin e përfaqëson Artan Qerkini, avokat në Shoqërinë e Avokatëve *"Sejdiu dhe Qerkini"* SH.P.K. në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës ,Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), PAKR. nr. 528/2018, të 16 prillit 2019, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), PKR. nr. 432/15, të 18 dhjetorit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës, në thelb, ngre pretendime për (i) shkeljen e parimit të *"barazisë së armëve"* dhe parimit të *"kontradiktoritetit",* si rezultat i mospranimit të provës së propozuar nga gjykatat e rregullta dhe (ii) interpretimin dhe zbatimin qartazi arbitrar të ligjit, si rezultat i cilësimit të tij si "*person zyrtar*" për shkak të aplikimit të analogjisë nga gjykatat e rregullta.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 17 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 20 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Bajram Ljatifi (anëtarë).

8. Më 14 janar 2020, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 27 janar 2020, Gjykata Themelore dorëzoi dosjen origjinale të rastit, si rezultat i kërkesës së saj për dorëzimin e dosjes në rastin KI239/19, në të cilën kërkesë janë vendimet e njëjta gjyqësore, të cilat kontestohen edhe nga parashtruesi tjetër H.V.. Rrjedhimisht, Gjykata pati mundësinë e qasjes dhe shqyrtimit të dosjes origjinale të rastit.

10. Më 16 shtator 2020, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen për këtë rast ta shtyjë për një seancë tjetër.

11. Më 9 dhjetor 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, përmes të cilit ishte propozuar që (i) kërkesa të shpallet e pranueshme; (ii) të konstatohet se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe parimit të barazisë së armëve janë të pabazuara dhe rrjedhimisht nuk ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe (iii) të konstatohet se vendimet e lartcekura të gjykatave të rregullta të cilat i referohen cilësimit të parashtruesit të kërkesës si person zyrtar janë nxjerrë në shkelje të nenit 33 [Parimi i Leglaitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së, si rezultat i përdorimit të analogjisë në të drejtën penale. Të njejëtën ditë, Kolegji Shyqrtues me shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

12. Po të njejtën ditë, Gjykata votoi si në vijim: (i) me shumicë votash konstatoi se kërkesa është e pranueshme; (ii) me shumicë votash konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si rezultat i mos arsyetimit të vendimit gjyqësor përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për cilësimin e tij si person zyrtar; dhe (iii) shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Pml. nr. 253/2019] të 30 shtatorit 2019 përkitazi me parashtruesin e kërkesës, duke vendosur që të kthejë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, për rivendosje në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në vijim, gjyqtari Radomir Laban, kërkoi që të paraqesë mendim konkurrues, të cilin e mbështetën gjyqtarët Bekim Sejdiu, Bajram Laftifi dhe Safet Hoxha.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 31 korrik 2015, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PSRK) ngriti aktakuzën (PPS. nr. 145/2014) kundër

parashtruesit të kërkesës për arsye se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale *"mashtrimi në detyrë"* nga neni 341, paragrafi 3, në lidhje me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK).

14. Me të njëjtën aktakuzë për bashkëkryerje të veprës penale të njëjtë, të cekur më lart, ishin akuzuar edhe dy persona të tjerë, i akuzuari i parë E.H., person zyrtar, rektor i Universitetit të Prishtinës (UP) dhe i akuzuari i dytë H.V., person zyrtar, shef i prokurimit në UP.

15. Parashtruesi i kërkesës u akuzua se në bashkëkryerje, si drejtor i një kompanie [kompania ISN] në Republikën e Shqipërisë kishte fituar kontratën me Universitetin e Prishtinës për përkthimin e disa librave, dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për kompaninë, kishte "falsifikuar kontratën origjinale", ku më pas ishte bërë edhe ndryshimi i kontratës, i cili i mundësoi kompanisë përfitim më të madh për sasinë e njëjtë të shërbimit.

16. Më 18 dhjetor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), përmes Aktgjykimit PKR. nr. 432/15, shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor sepse kishte kryer veprën penale *"mashtrimi në detyrë"* në bashkëkryerje me dy persona të tjerë të përmendur më lart dhe e gjykoi parashtruesin e kërkesës me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, duke ia zëvendësuar dënimin me burgim me dënim me gjobë në shumë prej 10,000 (dhjetëmijë) euro. Në vijim, Gjykata Themelore po ashtu i obligoi të pandehurit që Universitetit të Prishtinës t'ia kompensojnë dëmin në mënyrë solidare në shumë prej 70.131,27 euro, si dhe që të pandehurit në mënyrë solidare t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën nga 200 euro.

17. Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit PKR. nr. 432/15, shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor sepse kishte kryer veprën penale *"mashtrimi në detyrë"* në bashkëkryerje, duke arsyetuar se bashkëkryerësit janë fajtor:

Sepse:

Të akuzuarit E.H., person zyrtar Rektor i Universitetit të Prishtinës (UP), H.V. person zyrtar, Shef i prokurimit në UP dhe Albert Rakipi person zyrtar, Drejtor i Institutit për Studime Ndërkombëtare (ISN) nga Tirana, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për kompaninë ISN, sipas

marrëveshjes paraprake, kanë falsifikuar Kontratën origjinale "Përkthimi i librave nga gjuha angleze në gjuhën shqipe për nevojat e Universitetit të Prishtinës" me Ref. Nr. 43/8 të datës 05.12.2008, e cila kontratë në nenin 17 përcakton vlerën totale të kontratës në shumë prej 500,000.00 € dhe çmimin e pagesës 12.65 € për 1000 fjalë, ashtu që me 08 dhjetor 2008 zv. Drejtori i kompanisë IMS J.Q., i ka dërguar të akuzuarit E.H. kërkesë për ndryshimin e kontratës nga njësia matëse "fjala" në njësinë matëse "karaktere" ku pastaj i akuzuari H.V., sipas marrëveshjes me të akuzuarin E.H., ka përpiluar një kontratë të re në të cilën ka ndryshuar nenin 17 e kontratës origjinale, ashtu që në vend të çmimit 12.65 € për 1000 fjalë, ka shënuar çmimin 12.65 € për 1000 karaktere, duke i mundësuar në këtë mënyrë ISN-së përfitim më të madh për sasinë e njëjtë të shërbimit, dhe për të sjellë në lajthitje personat e autorizuar të UP-së, për kryerjen e pagesës së kundërligjshme, i akuzuari H.V. në kontratën e falsifikuar ka mbajtur numrin dhe datën e kontratës origjinale, të cilën kontratë i akuzuari E.H. me datën 13 dhjetorë 2008, e ka dërguar në Tiranë për ta nënshkruar i akuzuari Albert Rakipi, i cili pastaj në bazë të kontratës së falsifikuar me datën 13 korrik 2009 ka dërguar në UP faturën për përkthimin e tetë librave me çmim prej 78.999,25 €, e llogaritur sipas njësisë matëse „karaktere", që sipas kontratës origjinale e llogaritur sipas njësisë matëse „fjala" kishte kushtuar 14.991,91 €, si dhe faturën për përkthimin e dokumenteve të akreditimit të UP-së me çmim prej 8.542,55 €, e llogaritur sipas njësisë matëse „karaktere" që sipas kontratës origjinale e llogaritur sipas njësisë matëse „fjala" kishte kushtuar 106.083 €, dhe për të sjellë në lajthitje personat e autorizuar të UP-së për kryerjen e pagesës së kundërligjshme, i akuzuari Albert Rakipi në ato fatura ka shënuar shenjën 1.000/F, gjë që tek anëtarët e komisionit të UP-së për pranimin e materialit të përkthyer, ka krijuar lajthitje se llogaritja e përkthimit është bërë me njësinë matëse „fjala", kështu që ky komision duke aprovuar cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të kryera nga ISN, ka rekomanduar ekzekutimin e pagesës, ndërsa i akuzuari H.V. edhe pse dinte se ISN ka llogaritur çmimin e përkthimit sipas njësisë matëse „karaktere" me datën 07 shtator 2009 ka lëshuar urdhër blerje për pagesë në shumë prej 87.541,80 €, ndërsa me datën 17 shtator 2009 Shërbimi i Financave të UP-së këto para i transferoi ISN-së, në të cilën mënyrë të akuzuarit i siguruan kompanisë ISN përfitim të kundërligjshëm financiar në shumë prej 70.131,27 €, në dëm të UP-së. Me këtë në bashkëkryerje të pandehurit kanë kryer veprën penale Mashtrimi në detyrë nga neni 341 par. 3 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës."

18. Përmes Aktgjykimit të lartcekur, Gjykata Themelore, në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik, e cilësoi parashtruesin e kërkesës, si përfaqësuesin e kompanisë, me statusin e *"personit zyrtar"*. Gjykata Themelore vlerësoi *"Deklaratën nën Betim"* (si pjesë e dosjes së tenderit) përmes së cilës deklarohet: *"unë i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Institutin Për Studime Ndërkombëtare (operatorin ekonomik që dorëzon tenderin), deklaroj nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat e përshtatshmërisë të Ligjit Mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 2003/ 17, neni 61, siç citohet këtu më pas. Unë kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në fjalë dhe siguroj se operatori ekonomik në fjalë plotësisht i përmbush këto. Unë pranoj mendësinë e sanksioneve penale dhe civile, gjobave dhe dëmeve nëse operatori ekonomik në fjalë me qëllim apo për shkak të pakujdesisë dorëzon çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese"*.

19. Në bazë të kësaj *"Deklarate nën Betim"*, Gjykata Themelore vërtetoi se *"*është *fakt që i pandehuri Albert Rakipi e ka përfaqësuar Institutin si person zyrtar, ngase ka vepruar si organizatë biznesi - person juridik, sepse sipas Ligjit të Prokurimit Publik respektivisht dispozitës së nenit 61 të ligjit të përmendur, ka ushtruar detyra të posaçme, që lidhen me aktivitetin e prokurimit publik"*.

20. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij pretendoi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe të kërkesës pasurore juridike.

21. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike theksoi se Gjykata Themelore në mënyrë të paligjshme refuzoi që si provë materiale të administrohet korrespodenca përmes e-mailit në mes të zëvendësdrejtorit të kompanisë së drejtorit J.Q. dhe të akuzuarit tjetër H.V..

22. Së dyti, në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike, parashtruesi i kërkesës pretendoi se nuk është vërtetuar se parashtruesi i kërkesës kishte kryer veprën penale për të cilën ishte akuzuar, përkatësisht veprën penale të mashtrimit në detyrë, për arsye se në kohën kur pretendohet kryerja e veprës penale ai nuk e kishte statusin e *"personit zyrtar"*.

23. Së treti, përkitazi me kërkesën pasurore juridike, parashtruesi i kërkesës duke iu referuar dispozitave përkatëse të Kodit 04/L-123 të

Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPRK), përkatësisht nenit 459, theksoi se në këtë rast një kërkesë e tillë nuk është dorëzuar nga personi kompetent i autorizuar me ligj i cili duhet të parashtrojë kërkesën pasurore juridike për anulimin e një veprimi konkret në procedurë civile, dhe si rrjedhojë, në këtë rast është bërë tejkalimi i akuzës që përcaktohet sipas nenit 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.10 të KPPRK-së.

24. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, përkitazi me vendimin për dënim, ankesë kishte parashtruar edhe PSRK, duke kërkuar që parashtruesit të kërkesës t'i shqiptohet një dënim më i ashpër.

25. Më 2 maj 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit PAKR nr. 27/2018, në pikën I (një) aprovoi në tërësi ankesën e të akuzuarit të parë E.H., duke e ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, PKR. nr. 432/15, të 18 tetorit 2017. Gjykata e Apelit e liroi të akuzuarin e parë E.H. nga të gjitha akuzat, në pajtim me dispozitën e nenit 364 paragrafi, 1 pika 1.3 të KPPRK-së.

26. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit PAKR nr. 27/2018, në pikën II (dy), aprovoi ankesën e PSRK-së përkitazi me vendimin për dënim për parashtruesin e kërkesës dhe të akuzuarin e dytë H.V., dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore PKR. nr. 432/15 duke e ndryshuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh me të cilin ishin gjykuar parashtruesi i kërkesës dhe i akuzuari i dytë H.V. në procedurën e shkallës së parë dhe parashtruesit të kërkesës dhe të akuzuarit tjetër H.V. i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.

27. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 27/2018, në pikën III (tre), aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të akuzuarit tjetër H.V. në pjesën përkitazi me kërkesën pasurore juridike, duke e udhëzuar Universitetin e Prishtinës, në cilësinë e të dëmtuarit, në kontest civil, ndërsa në pjesët e tjera, ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar si e pabazuar.

28. Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit të saj, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për refuzimin e paligjshëm të administrimit të korrespodencës elektronike si provë materiale, theksoi si në vijim: *"[...] është gjykata ajo që e vlerëson ligjshmërinë e provave dhe sa ato provojnë elementet e veprës penale, shkaktimin e dëmit apo ndonjë çështje me rëndësi. Meqë në rastin konkret kemi të bëjmë me një provë për nxjerrjen e së cilës është dashtë të lëshohet një urdhërese nga gjykata dhe origjina e marrjes së saj nuk dihet [...]*

kjo Gjykatë vlerëson se me të drejtë Gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar administrimin e kësaj prove".

29. Ndërsa në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se ai nuk e ka statusin e *"personit zyrtar"*, Gjykata e Apelit vlerësoi se në lidhje me këtë pretendim Gjykata Themelore ka dhënë arsye të nevojshme, të cilat arsye *"[...] i aprovon edhe kjo Gjykatë dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësime".*

30. Së treti, sa i përket pretendimit përkitazi me kërkesën pasurore juridike, Gjykata e Apelit e konsideroi këtë pretendim si të bazuar, duke vlerësuar se Universiteti i Prishtinës, në cilësinë e palës së dëmtuar nuk ka parashtruar një kërkesë të tillë, dhe si rrjedhojë e udhëzoi këtë të fundit në kontest civil për realizimin e kësaj kërkese.

31. Në fund, në lidhje me ankesën e PSRK-së për lartësinë e dënimit, Gjykata e Apelit e pranoi aplikimin e rrethanave lehtësuese nga Gjykata Themelore në rastin e parashtruesit të kërkesës, megjithatë sipas saj, *"[...] ato nuk janë të asaj natyre që justifikojnë, ose janë të mjaftuara që të bëhet zbutja e dënimit nën kufirin e parashikuar me ligj [...]".*

32. Më 21 qershor 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 27/2018, të 2 majit 2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, PKR. nr. 432/15, të 18 dhjetorit 2017.

33. Në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje esenciale të ligjit penal, shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1 i KPPRK-së, dhe të dispozitave të tjera të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e aktgjykimeve të kontestuara të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit.

34. Në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të ligjit penal, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, theksoi se është aplikuar gabimisht neni 341, paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të KPPK-së, me arsyetimin se vepra penale *"mashtrim në detyrë"* mund të kryhet vetëm nga personi i cili në momentin e kryerjes së kësaj vepre e ka statusin e *"personit zyrtar"* të përcaktuar me dispozitat përkatëse ligjore.

35. Në lidhje me pretendimin për shkelje esenciale të dispozitave penale, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, theksoi se është cenuar parimi i *"barazisë së armëve"* dhe ai i *"kontradiktoritetit"* për arsye se gjykatat e rregullta kishin refuzuar propozimin e mbrojtjes për administrimin

e korrespodencës elektronike si provë materiale, gjë që, sipas parashtruesit të kërkesës, do të ndikonte drejtpërdrejtë në vërtetim të kundërt të gjendjes faktike.

36. Më tej, parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e aktgjykimeve të kontestuara. Në këtë kontekst, parashtruesi pretendon se parimi *"Beneficium Cohesionis*" nuk është aplikuar, si dhe shkeljen e të drejtës së tij për mbrojtje.

37. Në lidhje me pretendimin e tij për shkeljen e të drejtës së tij për mbrojtje, parashtruesi i kërkesës thekson që si rezultat i moscaktimit të shqyrtimit, respektivisht mosmbajtjes së seancës së Kolegjit të Apelit, atij i është mohuar prezantimi i provave të reja që, sipas tij, sikur këto prova relevante do të administroheshin nga gjykatat e shkallëve më të ulëta do të krijonin një gjendje krejtësisht të kundërt faktike.

38. Kundër aktgjykimeve të lartcekura të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kishte parashtruar edhe PSRK.

39. Më 15 tetor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Pml. nr. 238/2018, e aprovoi si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, duke e anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe duke e kthyer çështjen në të njëjtën gjykatë për rivendosje. Në anën tjetër, e njëjta gjykatë refuzoi, si të pabazuar, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga PSRK.

40. Gjykata Supreme, duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (rastit KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić,* Aktgjykim i 29 majit 2017) konstatoi se:

> *"[...] në rastin konkret me aktgjykimin e shkallës së dytë është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës se Kosovës lidhur me nenin 6 të KEDNJ. Kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret me të vërtetë të dënuarve në fjale iu është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, meqë te njëjtit siç pretendohet në kërkesat e mbrojtësve te tyre, nuk janë njoftuar për seancën e shkallës së dytë me qellim që të paraqesin aspektet dhe argumentet e tyre lidhur me këtë çështje penale."*

41. Gjykata Supreme konkludoi se: *"Në rivendosje gjykata e shkallës së dytë duhet të evitoj shkeljet e konstatuara më lartë ashtu që për seancën e radhës të njoftojë të dënuarit dhe mbrojtësit e tyre e më pas të merr një vendim të ligjshëm"*.

Procedura para gjykatave pas kthimit të rastit për rivendosje

42. Më 16 prill 2019, Gjykata e Apelit në procedurën e rivendosjes përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 528/2018, e aprovoi në tërësi ankesën e PSRK-së përkitazi me vendimin për dënim për parashtruesin e kërkesës dhe të akuzuarin tjetër H.V., duke e ndryshuar Aktgjykimin PKR. nr. 432/15 të Gjykatës Themelore, në atë mënyrë që dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, me të cilin janë gjykuar parashtruesi i kërkesës dhe i akuzuari i dytë H.V. në procedurën e shkallës së parë, e ndryshoi, dhe e gjykoi parashtruesin e kërkesës dhe të akuzuarin e dytë H.V. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.

43. Me të njëjtin Aktgjykim, Gjykata e Apelit në procedurën e rivendosjes e aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës në pjesën përkitazi me kërkesën pasurore juridike *(vetëm në lidhje me obligimin e të pandehurve për të kompensuar dëmit e shkaktuar)* dhe e udhëzoi Universitetin e Prishtinës në cilësinë e të dëmtuarit në kontest civil, ndërsa pjesën e mbetur të ankesës së parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar.

44. Gjykata e Apelit, në Aktgjykimin e saj në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se ai nuk e ka statusin e *"personit zyrtar"*, vlerësoi se:

> *"[...] qëndron fakti se [parashtruesi i kërkesës] është shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe se Instituti për Studime Ndërkombëtare të cilën e përfaqëson i akuzuari është i themeluar ne Shqipëri, por nga ky fakt nuk mund te konkludohet se ky i akuzuar në rastin konkret nuk e ka cilësinë e personit zyrtar. Sepse, sipas Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës nr. 2003/17 ky Institut si palë e interesuar ka ofertuar në Kosovë si operator ekonomik (ka ofruar shërbime respektivisht ka kontraktuar punë) dhe [parashtruesi i kërkesës] përveç që e përfaqëson Institutin si person zyrtar me rastin e fitimit te tenderit nga autoriteti kontraktues (Universiteti i Prishtinës) ka marrë përsipër ushtrimin e detyrave të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj."*

45. Ndërsa në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për refuzimin e administrimit të korrespodencës elektronike si provë materiale, Gjykata e Apelit konstatoi se: *"[...] kjo Gjykate arsyet e dhëna nga gjykata e shkalles së parë i ka mbështet me aktgjykimin PAKR. nr. 27/2018 datë 2 maj 2018 dhe meqë këto konkludime i ka mbështet edhe Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj PML. nr. 238/2018 datë 15.10.2018 kjo Gjykatë nuk do të bëjë vlerësime në ketë drejtim. Pastaj, edhe nen supozimin se këto korrespodenca elektronike janë prova të pranueshme fakti se [J.Q.] ka komunikuar me te akuzuarin [H.V.] rreth ndryshimit te kontratës bazë nuk e liron [parashtruesin e kërkesës] nga përgjegjësia penale sepse është pikërisht ky i akuzuar ai që e ka nënshkruar kontratën e ndryshuar"*.

46. Më tej, në lidhje me ankesën e PSRK-së për lartësinë e dënimit, Gjykata e Apelit e pranoi aplikimin e rrethanave lehtësuese nga Gjykata Themelore në rastin e parashtruesit të kërkesës, megjithatë sipas saj *"[...] ato nuk janë të asaj natyre që justifikojnë, ose janë të mjaftuara që të bëhet zbutja e dënimit nën kufirin e parashikuar me ligj [...]"*. Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit e aprovoi si të bazuar kërkesën e PSRK-së, duke i shqiptuar parashtruesit të kërkesës dënimin me burgim në kohëzgjatje prej (1) viti me arsyetimin se *"[...] këto dënime janë adekuate me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të [parashtruesit të kërkesës], dhe se me to mund të ndikohet në parandalimin e tyre nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tyre, por edhe në parandalimin e tjerëve nga kryerja e veprave penale, respektivisht do të mund të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitën e nenit 41 të [KPK-së]"*.

47. Në fund, sa i përket pretendimit lidhur me kërkesën pasurore juridike, Gjykata e Apelit i pranoi si pjesërisht të bazuara ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe të akuzuarit tjetër H.V. *(vetëm në lidhje me obligimin e të pandehurve për të kompensuar dëmin)* duke vlerësuar se Universiteti i Prishtinës, në cilësinë e palës së dëmtuar nuk ka parashtruar kërkesën pasurore juridike, dhe si rrjedhojë e udhëzoi këtë fundit në kontest civil për realizimin e kësaj kërkese.

48. Më 12 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 528/2018, të 16 prillit 2019, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, PKR. nr. 432/15, të 18 dhjetorit 2017.

49. Më 27 gusht 2019, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes shkresës KMLP II. nr. 176/2019, propozoi që kërkesa për mbrojtje të

ligjshmërisë, e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, të refuzohet si e pabazuar.

50. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë pretendoi: (i) shkelje të ligjit penal; (ii) shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1 i KPPRK-së; dhe (iii) shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e aktgjykimeve të kontestuara.

51. Së pari, në lidhje me pretendimin për shkelje të ligjit penal, parashtruesi i kërkesës theksoi se ai nuk e ka statusin e ***"personit zyrtar"***. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës specifikon se *"[...] operatorët ekonomikë nuk kualifikohen për të qenë "person zyrtar" sipas paragrafit (1) [të nenit 107 të Kodit të Përkohshëm Penal] meqë është e qartë se ata nuk janë të zgjedhur ose të emëruar në njësi publikë"*. Parashtruesi i kërkesës, më tej specifikon se në rastin konkret *"[...] shprehja ligj nënkupton ligjet vendore e jo edhe ato të shteteve të tjera, sepse po të ishte e kundërta, pra që kjo shprehje të nënkuptonte edhe ligjet e shteteve të tjera, atëherë një rrethanë e tillë do të paraqiste "agresion ligjor" të Kosovës në shtete tjera"*. Parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike pretendoi se: "*Zbatimi i Ligjit për Prokurim Publik për të dhënë statusin e personit zyrtar [të parashtruesit të kërkesës] është arbitrar, sepse ky ligj nuk merret fare me përcaktimin e statusit të personave zyrtarë, por përcakton procedurat e prokurimit në tenderët publike. Edhe sikur Ligji i Prokurimit te përcaktonte domethënien e shprehjes "person zyrtar" në të drejtën penale është e ndaluar analogjia andaj edhe dispozitat e këtij ligji nuk do te gjenin zbatim, sepse statusin e personit zyrtar mund ta kenë vetëm personat e përcaktuar në mënyrë taksative ne Kodin Penal. Ndalimi i aplikimit të analogjisë ne te drejtën penale është ne funksion të sigurisë juridike të subjekteve të së drejtës. Vërehet qartë se në këtë çështje penale Gjykata e Apelit e ka shkelur këtë parim. Ndalesa e analogjisë taksativisht është parashikuar me nenin 1 par 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës sipas te cilit: "Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet ne mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi në bazë të analogjisë"."*

52. Së dyti, parashtruesi i kërkesës pretendoi se në këtë rast është cenuar parimi i *"barazisë së armëve"* për arsye se gjykatat e rregullta kanë refuzuar administrimin e korrespodencës elektronike si provë materiale.

53. Së treti, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë po ashtu pretendoi se në Gjykatën e Apelit nuk është mbajtur procesverbal me shkrim.

54. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti një parashtresë të posaçme për plotësimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, përmes së cilës kishte kërkuar anulimin e Aktgjykimit PAKR. nr. 528/2018 të Gjykatës së Apelit, të 16 prillit 2019, me arsyetimin se Kolegji i Gjykatës së Apelit, i cili kishte vendosur në çështjen [PAKR. nr. 27/2018 të Gjykatës së Apelit, të 2 majit 2018] edhe pas rikthimit të rastit për rivendosje nga ana e Gjykatës Supreme, me përbërje të njëjtë kishte vendosur edhe në çështjen përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 528/2018, të 16 prillit 2019].

55. Më 30 shtator 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Pml. nr. 253/2019 e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.

56. Gjykata Supreme në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, të ngritur në plotësimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, vlerësoi se:

> *"Me rastin e vlerësimit të pretendimit të paraqitur në kërkesën e plotësuar për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se ky pretendim ishte i pabazuar pasi që nuk paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale fakti se pas kthimit të lëndës në rivendosje të behet ndryshimi i kolegjit të gjykatës së shkalles së dytë. Duke e pasur parasysh faktin se anulimi i aktgjykimit të gjykatës së shkalles së dyte ishte bërë vetëm për shkak të mos njoftimit të palëve për seancën e shqyrtimit në gjykatën e shkalles se dytë dhe se kjo shkelje ishte evituar në rivendosje nga ana e gjykatës së shkalles së dytë."*

57. Ndërsa në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se ai nuk ka pasur statusin e *"personit zyrtar",* Gjykata Supreme konstatoi se *"[...] vepra penale në fjalë mund ta kryhet ekskluzivisht nga personi zyrtar dhe me këtë rast gjykatat e instancave më të ulëta e kanë potencuar në vendimet e tyre faktin se [parashtruesi i kërkesës] kishte këtë cilësi, dhe për më tepër, kanë cituar dispozitat ligjore që përcaktojnë cilësinë e personit zyrtar edhe pse behet fjale për shtetas te Republikës se Shqipërisë dhe organizata "ISD" po ashtu kishte selinë në Tiranë, megjithatë nuk kishte dyshime se i dënuari kishte cilësinë e personit zyrtar pasi qe përveç faktit se ishte përfaqësues i "ISD-së" dhe kishte ofertuar ne Kosove si përfaqësues i operatorit ekonomik, kishte marre për sipër ushtrimin e posaçëm të detyrave zyrtare në bazë të autorizimit ligjor siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 107 te KPPK-së".*

58. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me mos administrimin e korrespodencës elektronike si provë materiale nga gjykatat e rregullta, Gjykata Supreme konstatoi se: *"Në rastin konkret del të jetë i pabazuar pretendimi përkitazi me cenimin e barazisë së armeve përkatësisht për mos pranimin e propozimeve të mbrojtjes për leximin e korrespodencës se komunikimeve të realizuara mes të dënuarit [H.V.] dhe drejtorit te "ISD" [J.Q.]. Gjykata e shkalles se pare në faqen e nëntë të aktgjykimit të saj ka arsyetuar faktin se pse nuk u pranua ky propozim i mbrojtjes dhe atë se nuk është e ditur se nga cila pajisje janë nxjerre këto komunikime se nuk ka pasur ekspertizë përkitazi me këto komunikime, dhe për me tepër, për pranimin e këtyre provave nevojitej paraprakisht të kishte urdhër të veçantë nga ana e gjykatës për përgjimin e tyre, andaj, për këtë arsye nuk janë plotësuar kushtet qe këto komunikime të pranohen si prova".*

59. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës të ngritur në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë se në Gjykatën e Apelit nuk është mbajtur procesverbal me shkrim, Gjykata Supreme konstatoi se ky pretendim është i pabazuar për arsye se një procesverbal i tillë gjendet në shkresat e lëndës.

60. Si përfundim, Gjykata Supreme konstatoi se aktgjykimet e kundërshtuara të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

61. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, dhe nenin 10 të DUDNJ-së.

62. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij, në thelb, ngre dy pretendime të ndryshme, përkatësisht pretendime për (i) cenimin e parimit të "barazisë së armeve" dhe "parimit të kontradiktoritetit", si rezultat i mospranimit të provës së propozuar nga gjykatat e rregullta dhe (ii) interpretimin dhe zbatimin e ligjit në mënyrë qartazi arbitrare, si rezultat i cilësimit të tij si *"person zyrtar"* për shkak të aplikimit të analogjisë nga gjykatat e rregullta.

(i) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për cenimin e parimit të "barazisë së armëve" dhe "parimit të kontradiktoritetit", si rezultat i mospranimit të provës së propozuar nga gjykatat e rregullta

63. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, para gjykatave të rregullta, respektivisht para Gjykatës Themelore, kishte propozuar që korrespodenca elektronike në mes të J.Q. dhe H.V., të shqyrtohet si provë materiale. Në kontekstin e këtij propozimi, parashtruesi i kërkesës para gjykatave të rregullta në vazhdimësi kishte pohuar se procedura e ndryshimit të kontratës ishte zhvilluar në mes të J.Q. dhe H.V..

64. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës, përkitazi me parimet e *"barazisë së armëve"* dhe të *"kontradiktoritetit",* i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), duke nënvizuar se *"në praktikën gjyqësore, GJEDNJ ka përcaktuar se parimi i "barazisë së armëve" është një nga elementet kyçe të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor"*. Në lidhje me parimet e zhvilluara nga GJEDNJ-ja përkitazi me parimin e barazisë së armëve, parashtruesi i referohet rasteve si në vijim: *Nideröst-Huber kundër Zvicrës*, 18 shkurt 1997, paragrafi 23; *Kress kundër Francës* [DHM], kërkesa nr. 39594/98, paragrafi 72; *Yvon kundër Francës*, kërkesa nr. 44962/98, paragrafi 31; *Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës*, kërkesa nr. 62543/00, paragrafi 56; *Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, kërkesa nr. 21510/03, Aktgjykim i 31 majit 2007. Në vijim, parashtruesi i kërkesës, në lidhje me çështjen e respektimit të parimit të barazisë së armëve në procedurë, ashtu siç është përcaktuar nga GJEDNJ-ja, përmend edhe rastet si në vijim: *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, Aktgjykim i 27 tetorit 1993; *Bulut kundër Austrisë*, Aktgjykim i 22 shkurtit 1996; dhe *Komanicky kundër Sllovakisë*, Aktgjykim i 4 qershorit 2002 paragrafi 45; *Matyjek kundër Polonisë*, paragrafi 65; *Perić kundër Kroacisë* dhe *Edward dhe Lewis kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës po ashtu i referohet edhe Vendimit V-III-1188/2010 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, të 7 nëntorit 2013.

65. Parashtruesi i kërkesës në vijim thekson se: *"Në sistemin tonë procedural, Gjykata pranon se çmon provat e paraqitura nga palët. Duke iu referuar këtij sistemi, për provat e paraqitura në formë të dokumenteve nga i pandehuri, gjykata duhet të realizojë veprimet e nevojshme për saktësimin e vërtetësisë së tyre nëse ajo e vë në dyshim autenticitetin"*.

66. Parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar Qarkores së Gjykatës Supreme [12/2015] të 12 janarit 2015, pohon se refuzimi i administrimit të komunikimit elektronik si provë materiale nga ana e gjykatave të rregullta është në kundërshtim me këtë Qarkore, e cila sipas parashtruesit *"iu lejon Gjykatave dhe Prokurorisë të ndërmarrin secilin veprim procedural me qëllim të sigurimit të provave relevante për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit"*.

67. Në vijim, në dritën e pretendimit të tij për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit, parashtruesi i kërkesës nënvizon se parimi i barazisë së armëve, i cili është vendosur nga GJEDNJ-ja, nuk është respektuar në rastin e tij. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës specifikon si në vijim: *"Komunikimet elektronike të propozuara nga dhe të refuzuara nga Gjykatat e instancave më të ulta ishin provat relevante të cilat do të dëshmonin pafajësinë e [parashtruesit të kërkesës]. Këto komunikime elektronike, po ashtu janë prova relevante të cilat do të dëshmonin tërë ecurinë dhe procesin e ndryshimit të kontratës, përkatësisht se cilët persona ishin të implikuar në këtë proces dhe do e dëshmonin mosekzistimin e elementit të dashjes në anën e [parashtruesit të kërkesës]"*.

68. Parashtruesi i kërkesës në vijim thekson se: *"Është paradoksale kur Trupi gjykues i cili e refuzoj propozimin që komunikimet elektronike të administrohen si prova materiale, i parashtron pyetje të pandehurve që ndërlidheshin drejtpërdrejtë me këto komunikime, kurse Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme e vlerësojnë si të drejtë këtë veprim.*

Po ashtu Gjykatat e rregullta gabojnë kur si pretekst të papranueshmërisë së email-ave si prova theksojnë se këto prova do të ishin të pranueshme vetëm nëse do të siguroheshin me rastin e aplikimit të masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit. Provat sigurohen ne këtë mënyrë vetëm kur Prokuroria e shtetit kërkon sigurimin e tyre, e jo edhe kur i pandehuri vullnetarisht i paraqet komunikimet elektronike për t'u administruar si prova.
*Gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore se komunikimet elektronike të zhvilluara në mes të dëshmitarit [J.Q.] dhe të pandehurit [*H.V.*] janë prova të papranueshme bëjnë gabime elementare si në vijim:*
Është në tërësi konfuz dhe i papranueshëm konkluzioni i Gjykatave te rregullta se edhe sikur të administroheshin si provë komunikimet elektronike epilogu për [parashtruesin e kërkesës] do të ishte i njëjtë. Ky qëndrim është konfuz sepse nuk është e qartë se a konsiderohen

email-at si prova te papranueshme, apo se Gjykatat e rregullta janë lëshuar në vlerësimin e fuqisë provuese te tyre."

(ii) Pretendimet e parashtruesit për interpretimin dhe zbatimin qartazi arbitrar të ligjit, si rezultat i cilësimit të tij si "person zyrtar" për shkak të aplikimit të analogjisë nga gjykatat e rregullta

69. Në lidhje me pretendimin e tij për interpretimin dhe zbatimin qartazi arbitrar të ligjit për shkak të aplikimit të analogjisë nga gjykatat e rregullta, parashtruesi i kërkesës pretendon si në vijim:

> *"Parashtruesi është dënuar për veprën penale nga neni 341 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës "mashtrim në detyrë". Mashtrimi në Detyrë mund të kryhet vetëm nga "personi zyrtar". Duke e marre parasysh faktin se OJQ "ISN" (Republika e Shqipërisë) ka qene në marrëdhënie kontraktuale me Universitetin e Prishtinës, pyetjet e radhës të cilat duhet të adresohen janë:*
>
> > *a. Nëse secilit operatore ekonomik duhet t'i ipet statusi i "personit zyrtar" sipas kodit të përkohshëm penal, si dhe:*
> > *b. A ka mundësi qe të këtë statusin e personit zyrtar personi përgjegjës i një OJQ-je të huaj e cila nuk është e regjistruar në Republikën e Kosovës."*

70. Në lidhje me nocionin e *"personit zyrtar"*, parashtruesi i kërkesës i referohet dispozitave të Kodit të Përkohshëm Penal, përkatësisht nenit 107 (1), i cili parasheh:

> *"(1) Termi "person zyrtar" do të thotë: 1) Personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ publik; 2) Personi i autorizuar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik,* ***i cili me ligj apo me dispozite tjetër nxjerrë në pajtim me ligjin,*** *ushtron autoritet publik, dhe që brenda këtij autoriteti ushtron detyra të posaçme; 3) Një person i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të parashikuara me ligj."*

71. Lidhur me këtë, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës *"Duket qartë se operatorët ekonomik nuk kualifikohen për të qenë "person zyrtar" sipas paragrafit (1) meqë është e qartë se ata nuk janë të zgjedhur ose të emëruar në një njësi publike".*

72. Parashtruesi i kërkesës vazhdon duke pretenduar se: *"[...] shprehja ligj nënkupton ligjet vendore e jo edhe ato të shteteve të tjera, sepse po të ishte e kundërta, pra që kjo shprehje të nënkuptonte edhe ligjet e shteteve të tjera, atëherë një rrethanë e tillë do të paraqiste*

*"agresion ligjor" të Kosovës në shtetet e tjera. Është më se e qartë se shprehja e përdorur në Kodin Penal "**Një person i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të parashikuara me ligj**" nënkupton autorizimet që burojnë nga ligjet vendore. Autorizimet të cilat i ka [parashtruesi i kërkesës] në OJQ "ISN" burojnë në ligjet e Republikës së Shqipërisë e jo nga ato të Republikës së Kosovës. Ky fakt vërtetohet edhe nga vet konkluzionet e Gjykatës së Apelit e të cilat përkrahen edhe nga Gjykata Supreme ku në mes tjerash thuhet se "Instituti për Studime Ndërkombëtare" është i themeluar në Shqipëri."*

73. Parashtruesi i kërkesës më tej arsyeton se: *"Zbatimi i Ligjit për Prokurim Publik për te dhënë statusin e personit zyrtarë [parashtruesit të kërkesës] është arbitrar, sepse ky ligj nuk merret fare me përcaktimin e statusit të personave zyrtare, por përcakton procedurat e prokurimit në tenderët publike. Edhe sikur Ligji i Prokurimit të përcaktonte domethënien e shprehjes "person zyrtare" në të drejtën penale është e ndaluar analogjia andaj edhe dispozitat e këtij ligji nuk do të gjenin zbatim, sepse statusin e personit zyrtarë mund ta kenë vetëm personat e përcaktuar në mënyrë taksative në Kodin Penal".*

74. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson se: *"Ndalimi i aplikimit të analogjisë në të drejtën penale është në funksion të sigurisë juridike të subjekteve të së drejtës. Vërehet qartë se në këtë çështje penale Gjykatat e rregullta e kanë shkelur këtë parim. Ndalesa e analogjisë taksativisht është parashikuar me nenin 1 par 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës sipas të cilit: "Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi në bazë të analogjisë"."*

75. Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës rithekson se në rastin konkret bëhet fjalë për interpretim arbitrar të ligjit për arsye se në këtë rast: *"[...] Gjykatat e rregullta në mënyrë arbitrare i kanë dhënë [parashtruesit të kërkesës], Drejtor Ekzekutiv i një OJQ-je të huaj (të Republikës së Shqipërisë), statusin e personit zyrtarë dhe e kanë quajtur mashtrim një marrëveshje të bazuar në vullnetin e palëve".*

76. Në fund, parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës që:

(i) të aprovojë kërkesën e tij si të pranueshme;
(ii) të urdhërojë, në përputhje me rregullin 42 të Rregullores së Punës, mbajtjen e seancës dëgjimore, dhe
(iii) të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës së

Republikës së Kosovës, nenin 10 të DUDNJ-së dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i shkeljeve nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme të një mori të drejtash të parashtruesit të garantuara me këto instrumente dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, dhe

(iv) të përcaktojë çfarëdo mase tjetër juridike që kjo Gjykatë e nderuar e vlerëson si të bazuar juridikisht dhe të arsyeshme.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.

[...]

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Neni 10

Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet

ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Neni 7
(Nuk ka dënim pa ligj)

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.
2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara

Kodi i Përkohshëm Penal [Rregullore e UNMIK-ut 2003/25]

KAPITULLI I:
Dispozitat e përgjithshme
Neni 1
PARIMI I LIGJSHMËRISË

[...]

3. Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit i cili hetohet, ndiqet ose shpallet fajtor.

Neni 23
BASHKËKRYERJA

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepra penale.

Neni 107

(1) Shprehja "person zyrtar" do të thotë:

1) Personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ publik;
2) Personi i autorizuar në një organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit a ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligjin ushtron autoritet publik dhe brenda këtij autoriteti ushtron detyra të posaçme;
3) Personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj;
4) Personi i cili është anëtar i personelit të UNMIK-ut ose i KFOR-it pa cenuar imunitetin dhe privilegjet e zbatueshme që i janë dhënë atij personi;
5) Personi i cili është anëtar i personelit të zyrave të ndërlidhjes në Kosovë;
6) Personi në një organizatë publike ndërkombëtare ose mbinacionale i cili njihet si zyrtar ose punonjës tjetër i kontraktuar sipas rregulloreve të personelit të organizatës së tillë;
7) Gjykatësi, prokurori ose zyrtari tjetër në gjykatën ndërkombëtare që ushtron juridiksion në Kosovë.

(2) Shprehja "person përgjegjës" do të thotë një individ në një organizatë biznesi ose një person juridik, të cilit, për shkak të funksionit apo autorizimit të posaçëm, i janë besuar detyrat që lidhen me zbatimin e ligjit ose të dispozitave të tjera të nxjerra në bazë të ligjit apo të rregullave të përgjithshme të organizatës së biznesit, ose personat e tjerë juridikë në qeverisjen apo administrimin e pronës, ose në lidhje me udhëheqjen e prodhimit apo ndonjë proces tjetër ekonomik ose mbikëqyrjen e procesit të tillë. Sipas paragrafit 2 të këtij neni, person zyrtar konsiderohet edhe personi përgjegjës, kur është në pyetje veprimi i cili nuk është paraparë me dispozitat e kapitullit mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe kundër detyrës tjetër ose me dispozitat e veprave penale të personit zyrtar të parapara në ndonjë kapitull tjetër të këtij Kodi.

(3) Kur një person zyrtar ose person përgjegjës përshkruhet si kryerës i një vepre penale, të gjithë personat e cekur në paragrafët 1 ose 2 të këtij neni mund të jenë kryerës të veprës së tillë penale me kusht që ajo nuk pason nga elementet e veprës penale ku kryerësi mund të jetë vetëm njëri nga ata persona.

Neni 261

MASHTRIMI

(1) Kushdo që me qëllim për t'i sjellë vetes apo personit tjetër ndonjë dobi pasurore e mashtron ose e sjell personin tjetër në lajthim me anë të paraqitjes së rreme apo duke i fshehur faktet dhe me këtë e shtyt personin e tillë që të veprojë apo të mosveprojë në dëm të pasurisë së tij ose të pasurisë së ndonjë personi tjetër, dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.
(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dëm i cili e tejkalon shumën prej 15,000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Neni 332
FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE

(1) Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal dënohet me gjobë apo burgim deri në një vit.

(2) Tentativa për vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, regjistrin publika apo zyrtar ose ndonjë regjistri tjetër që ruhet në bazë të ligjit, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Neni 341
MASHTRIMI NË DETYRË

1. Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër bën prezentimin e rremë të raportit të llogarive apo i cili në mënyrë tjetër e vë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës së kundërligjshme dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

[...]

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon 5.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Neni 87
Përkufizimi i masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit gjatë hetimit paraprak

Për qëllime të këtij Kapitulli:
1. Masa të fshehta ose teknike të vëzhgimit dhe hetimit ("masa sipas këtij kapitulli") do të thotë secila nga këto masa të mëposhtme:
1.1. vëzhgim i fshehtë fotografik ose me video;
1.2. monitorim i fshehtë i bisedave;
1.3. kontrollim i dërgesave postare;
1.4. përgjimi i telekomunikimeve dhe duhet të përdoret Lexuesi – IMSI – Identifikimi Ndërkombëtar i Shfrytëzuesit Mobil;
1.5. përgjim i komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik;
1.6. dërgim i kontrolluar i dërgesave postare;
1.7. shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes;
1.8. blerje e simuluar e ndonjë sendi;
1.9. stimulim i veprës së korrupsionit;
1.10. hetim i fshehtë;
1.11. regjistrim i thirrjeve telefonike; dhe
1.12. zbulim i të dhënave financiare.
[...]

Neni 88
Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video, monitorimi i fshehtë i bisedave në vende publike, regjistrimi i thirrjeve telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare mund të urdhërohet kundër një personi apo vendi të caktuar, nëse:
1.1. ekziston dyshimi i bazuar se vendi është përdorur ose personi i tillë ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ose në rastet kur tentativa është e ndëshkueshme, ka tentuar të kryejë vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare; dhe
1.2. informacioni i cili mund të merret nga masat e urdhëruara ka gjasë të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

2. Regjistrimi i bisedave telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare po ashtu mund të urdhërohet kundër personave, përpos të dyshuarit, kur kushti në nën-paragrafin 1.1. të paragrafit 1. të këtij neni vlen për të dyshuarin dhe kur plotësohet parakushti nga paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. i këtij neni dhe ekziston dyshim i bazuar se:

2.1. personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit apo që merr pjesë në transaksionet financiare të të dyshuarit; ose

2.2. i dyshuari përdor telefonin e personit të tillë.

3. Monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, ndërhyrja e komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, blerja e simuluar e ndonjë sendi, simulimi i një vepre të korrupsionit apo hetimi i fshehtë mund të urdhërohen kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse:

3.1. ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë vepër penale nga neni 90 i këtij Kodi;

3.2. informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

4. Kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve ose përgjimi i komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik po ashtu mund të urdhërohen kundër personit, përpos të dyshuarit, kur kushti nga paragrafi 3. nën-paragrafi 3.1. i këtij neni vlen për të dyshuarin dhe kur plotësohet parakushti nga paragrafi 3. nën-paragrafi 3.2. i këtij neni dhe ekziston dyshim i bazuar se:

4.1. personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit; ose

4.2. i dyshuari përdor telefonin e personit të tillë ose ka qasje në sistem kompjuterik.

Ligji Nr. 2003/17 për Prokurimin Publik

Neni 61

Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve

61.1 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj:

a. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose
b. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjesë të këtyre të fundit.

61.2 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara;
a. është dënuar nga një gjykatë kompetente për vepër penale duke përfshirë praktikimin e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, shantazh ose aktivitetet e përshkruara ose të ngjashme me ato të përshkruara në nenin 117.1 të këtij ligji, në ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë ose në cilindo vend, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;
b. është deklaruar i papërshtatshëm, për shkak të sjelljeve të përmendura më lart, nga çfarëdo banke, institucioni ose organizate e cila ofron fonde për zhvillim të përgjithshëm, investim publik ose rindërtim;
c. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprën penale të pjesëmarrjes në një organizatë kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme; ose
d. është dënuar nga një gjykatë kompetente për vepër penale të mashtrimit ose të barabartë me mashtrimin;
e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjensi administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellur në mënyrë joprofesionale; ose
f. është konstatuar nga KRPP-ja në bazë të dëshmive substanciale, se është sjellur në mënyrë joprofesionale ose ka bërë keqinterpretime serioze në dokumentet e dorëzuara lidhur me procedurat e prokurimit ose aktivitetet e

udhëhequra që qeverisen nga ligji publik në Kosovë ose diku tjetër.

61.3 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik:

a. gjatë dy viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent;

b. me vendim të një gjykate kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;

c. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paaftë që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;

d. është në një situatë të ngjajshme me ato të përshkruara në a, b ose c më lartë, që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;

e. aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga ose për një operatori të tillë ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjesshme të të drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij.

f. aktualisht është lëndë e një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon ose redukton pagesat nga ose për operatorët e tillë ekonomik nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë në vendimin për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;

g. gjatë tri viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë njësi publike, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë ose diku tjetër;

h. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik;

i. aktualisht është me vonesë për pagimin e tatimeve në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose

j. ende nuk është pajtuar me një vendim të lëshuar nga KRPP-ja ose një panel shqyrtues.

61.4 Periudhat kohore të përcaktuara në këtë nen, ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim.

61.5 Komisioni i Rregullave për Prokurim Publik krijon dhe miraton rregullat që kanë të bëjnë me llojet e dokumenteve, dëshmive dhe/ose deklaratat që operatori ekonomik duhet t'i ofrojë në mënyrë që operatori ekonomik të demonstrojë se ai nuk përjashtohet në bazë të një dispozite të këtij neni 61. Komisioni i Rregullave për Prokurim Publik do të sigurojë që rregullat e tilla të mos kërkojnë në mënyrë të rreptë dokumente ose deklarata që nuk janë në dispozicion në vende ose rajone të caktuara. Komisioni i Rregullave për Prokurim Publik do të sigurojë që rregullat e tilla në masë të arsyeshme të rregullojnë mundësitë e operatorëve ekonomik nga ana e tyre, duke u lejuar paraqitjen e deklaratave të tyre nën betim, deklaratat e notarizuara e të ngjajshme. Në të gjitha rastet operatori ekonomik që paraqitet duhet të pranojë mundësinë e vendosjes së sanksioneve penale dhe civile, penaleve dhe dëmeve ndaj tij, nëse operator i tillë ekonomik, me dashje ose nga pakujdesia ka paraqitur çfarëdo dokumenti, deklaratë ose formulimi, që përmban informata përmbajtësisht të rrejshme ose mashtruese.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

77. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

78. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

79. Gjykata, gjithashtu, vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë të përcaktuara në nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, si dhe në rregullin 39 të Rregullores së Punës, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afati]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]."

Rregulli 39
Kriteret e pranueshmërisë

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar,
(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar,
(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit 20 efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe
(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(i) Lidhur me palën e autorizuar dhe aktin e autoritetit publik

80. Sa i përket përmbushjes së kritereve të lartcekura, Gjykata së pari konstaton se parashtruesi i kërkesës është një individ i cili parashtroi një kërkesë individuale sepse konsideron se ai është viktimë dhe se të drejtat dhe liritë e tij individuale janë shkelur nga një autoritet publik, prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar.

81. Më tej, parashtruesi i kërkesës konteston disa akte të autoriteteve publike, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 528/2018, të 16 prillit 2019 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore PKR. nr. 432/15, të 18 dhjetorit 2017.

82. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës (i) është palë e autorizuar dhe (ii) konteston disa akte të autoriteteve publike, siç përcaktohet në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 1 të nenit 47 të Ligjit, pikën (a) të paragrafit (1) të rregullit 39 dhe paragrafin (2) të rregullit 76 të Rregullores së punës.

(ii) Lidhur me shterimin e mjeteve juridike

83. Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj dhe rrjedhimisht konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka përmbushur kriterin e pranueshmërisë lidhur me shterimin e mjeteve juridike, të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(iii) Lidhur me saktësimin e kërkesës dhe afatin

84. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë shkelur dhe e ka specifikuar aktin konkret të autoritetit publik të cilin e konteston në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe dispozitat përkatëse të Rregullores së punës, si dhe e ka parashtruar kërkesën e tij brenda afatit prej katër

(4) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

(iv) Lidhur me kriteret e tjera të pranueshmërisë

85. Në fund dhe pas shqyrtimit të ankesës kushtetuese të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashihet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih, gjithashtu rastin e GJEDNJ-së: *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykim, i 9 korrikut 2012, paragrafi 144, si dhe shih në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës KI27/20, parashtrues *Lëvizja VETËVENDOSJE!*, Aktgjykim, i 22 korrikut 2020, paragrafi 43).

86. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të deklarohet e papranueshme në bazë të kritereve të përcaktuara në paragrafin (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundimi lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

87. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës (i) është palë e autorizuar dhe konteston aktin e autoritetit publik; (ii) i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; (iii) i ka saktësuar të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë për të cilat pretendon se i janë shkelur; (iv) e ka dorëzuar kërkesën e tij brenda afatit; (v) se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe (vi) nuk ekziston asnjë kriter tjetër i pranueshmërisë i cili nuk është përmbushur.

88. Rrjedhimisht, Gjykata e deklaron kërkesën të pranueshme.

Meritat e kërkesës

89. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 528/2018, të 16 prillit 2019, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, PKR. nr. 432/15, të 18 dhjetorit 2017 janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të

Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së.

90. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës, në thelb, ngre dy çështje, përkatësisht pretendimet për (i) cenimin e parimit të *"barazisë së armëve"* dhe *"parimit të kontradiktoritetit"*, si rezultat i mospranimit të provës së propozuar nga gjykatat e rregullta dhe (ii) interpretimin dhe zbatimin qartazi arbitrar të ligjit, si rezultat i cilësimit të tij si *"person zyrtar"* për shkak të aplikimit të analogjisë nga gjykatat e rregullta.

91. Gjykata, në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, fillimisht do të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtave të tij që kanë të bëjmë me (i) parimin e "barazisë së armëve" dhe atë të "kontradiktoritetit", për të vazhduar me (ii) pretendimet e parashtruesit për interpretimin dhe zbatimin qartazi arbitrar të ligjit për shkak të aplikimit të analogjisë nga gjykatat e rregullta. Gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së këtyre pretendimeve, Gjykata gjithashtu do të zbatojë standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Sa i përket pretendimeve në lidhje me shkeljet e parimit të kontradiktoritetit dhe parimit të barazisë së armëve

92. Gjykata, fillimisht, rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse i është pamundësuar paraqitja e provave që janë në favor të tij. Sipas tij, pamundësia për të paraqitur prova që janë në favor të tij, përkatësisht mosaprovimi i korrespodencës elektronike nga ana e gjykatave të rregullta përbën cenim të parimit të *"barazisë së armeve"* dhe parimit të *"kontradiktoritetit"*. Gjykata vëren se këto pretendime sipas parashtruesit të kërkesës paraqesin shkelje të të drejtave të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

93. Gjykata, po ashtu, rikujton se parashtruesi i kërkesës në lidhje me pretendimin e tij për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit, i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht rasteve: *Neumeister kundër Austrisë*, kërkesa nr. 1936/63, Aktgjykim i 27 qershorit 1968, paragrafi 2; *Nideröst-Huber kundër Zvicrës*, 18 shkurt 1997, paragrafi 23; *Kress*

kundër Francës [DHM], kërkesa nr. 39594/98, paragrafi 72; *Yvon kundër Francës*, kërkesa nr. 44962/98, paragrafi 31; *Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës*, kërkesa nr. 62543/00, paragrafi 56; *Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, kërkesa nr. 21510/03, Aktgjykim i 31 majit 2007; *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993; *Edwards dhe Lewis kundër Mbretërisë së Bashkuar*; *Bulut kundër Austrisë*, Aktgjykim i 22 shkurtit 1996; *Komanicky kundër Sllovakisë*, Aktgjykim i 4 qershorit 2002 paragrafi 45; *Matyjek kundër Polonisë*, paragrafi 65; dhe *Perić kundër Kroacisë*.

94. Në lidhje me këtë, Gjykata gjatë shqyrtimit dhe elaborimit të parimeve të përgjithshme të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit do të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse rastet e referuara nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij kanë të bëjnë me rrethanat e ngjashme faktike dhe juridike si në rastin e tij dhe po ashtu do të vlerësojë nëse këto raste mund të aplikohen edhe në rastin e tij.

95. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë parimet e përgjithshme të zhvilluara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me barazinë e armëve dhe parimin e kontradiktoritetit, dhe po ashtu do t'i referohet edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me çështjen e pranueshmërisë së provave në procedurën penale.

96. Rrjedhimisht, Gjykata do të zbatojë parimet e përgjithshme të zhvilluara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në rrethanat juridike të rastit konkret, përkatësisht në rastin e parashtruesit të kërkesës dhe në bazë të të njëjtave do të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimeve të kontestuara.

(i) Parimet e përgjithshme në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës, si dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së

97. Gjykata, duke iu referuar edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, fillimisht thekson se parimi i *"barazisë së armëve"* është element i një koncepti më të gjerë të një gjykimi të drejtë.

98. GJEDNJ-ja dhe Gjykata, në praktikën e tyre gjyqësore, kanë theksuar se parimi i *"barazisë së armëve"*, kërkon një *"ekuilibër të drejtë midis palëve",* ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqes rastin e tij/saj nën kushte që nuk do të vendosin atë në disavantazh të konsiderueshëm *vis-à-vis* palës kundërshtare (shih rastet e GJEDNJ-së *Yvon kundër Francës,* kërkesa nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe *Dombo Beheer B.V.*

kundër Holandës, kërkesa nr. 14448/88*,* Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33, shih dhe referencat tjera në këtë Aktgjykim, *Öcalan kundër Turqisë* [DHM], paragrafi 140, shih rastet e Gjykatës, KI52/12, parashtrues *Adije Iliri*, Aktgjykim i 5 korrikut 2013, KI103/10, parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykim i 20 marsit 2012, paragrafi 40*)*.

99. Gjykata më tej rikujton se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka përcaktuar se kërkesa e barazisë së armëve, në kuptim të një ekuilibri të drejtë midis palëve, vlen në parim si për rastet civile ashtu edhe për ato penale (shih *Dombo Beher B.V. kundër Holandës*, Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33).

100. Për më tepër, Gjykata gjithashtu thekson se gjykimi i drejtë përfshin edhe të drejtën e gjykimit në pajtim me *"parimin e kontradiktoritetit",* parim i cili është i ndërlidhur me parimin e *"barazisë së armëve"*.

101. Për më tepër, në kuadër të procedurës penale, GJEDNJ ka nënvizuar se *"Është një aspekt themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë që procedurat penale, përfshirë edhe elementet e procedurave të tilla që kanë të bëjnë me vetë procedurën, duhet të jenë në pajtim me parimin e kontradiktoritetit dhe se duhet të ekzistojë barazia e armëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes"* (shih rastin e GJEDNJ-së *Leas kundër Estonisë,* kërkesa nr. 59577/08, Aktgjykim i 6 marsit 2012, paragrafi 77*)*. Rrjedhimisht, përkitazi me parimin e kontradiktoritetit, GJEDNJ theksoi se, në një procedurë penale, si prokuroria ashtu edhe mbrojtja duhet të kenë mundësinë që të kenë njohuri dhe të bëjnë komente për të gjitha vërejtjet dhe për të gjitha provat e paraqitura nga pala tjetër (shih rastin *Brandstetter kundër Austrisë,* të cituar më lartë*,* paragrafi 67).

102. Në anën tjetër, përkitazi me çështjet që ndërlidhen me paraqitjen e provave dhe pranueshmërinë e tyre, Gjykata po ashtu i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila, në parim ka theksuar se *"Ndonëse neni 6 e garanton të drejtën për një proces të rregullt, ai megjithatë nuk përcakton rregulla për pranueshmërinë e provave si të tillë, një fushë kjo që u përket për këtë arsye në radhë të parë të drejtës së brendshme dhe juridiksioneve kombëtare"* (shih rastet e GJEDNJ-së *Schenk kundër Zvicrës*, paragrafët 45-46 dhe *Heglas kundër Republikës Çeke*, paragrafi 84). Megjithatë, GJEDNJ ka nënvizuar se aspekti që duhet shqyrtuar në këto raste është nëse procedura, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj (shih rastin e GJEDNJ-së *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar,* paragrafi 34; *P.G. e J.H. kundër*

Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 76; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 42).

(ii) Aplikimi i këtyre parimeve në rastin e parashtruesit të kërkesës

103. Gjykata fillimisht rithekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, vlerësohen në kuptim të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm në tërësinë e tij. Për më tepër, siç është cekur më lart, çështjet që ndërlidhen me pranueshmërinë e provave janë, në parim, çështje të ligjit dhe rrjedhimisht, të vlerësimit të gjykatave të rregullta (shih, në mënyre analoge, rastin KI14/18, parashtrues Hysen Kamberi, Aktgjykim i 15 janarit 2020, paragrafi 68).

104. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendimin e tij për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit në mënyrë specifike e ndërlidhë më refuzimin e gjykatave të rregullta për të administruar komunikimin elektronik si provë materiale.

105. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjatë zhvillimit të procedurës penale si provë materiale para Gjykatës Themelore kishte paraqitur edhe korrespodencën elektronike në mes J.Q. [në cilësinë e tij si zëvendësdrejtor i kompanisë ISN] dhe H.V. [parashtruesit të kërkesës në rastin KI230/10].

106. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit PKR. nr. 432/15, të 18 dhjetorit 2017, kishte refuzuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për leximin e kësaj korrespodence me arsyetimin si në vijim*: "Propozimin fillimisht nuk e ka përkrahur Prokurorja por gjatë rrjedhës së procedurës e ka përkrahur dhe e ka përsëritur të njëjtin propozim, Gjykata këtë propozim e ka refuzuar me arsyetimin se: bazuar në nenin 87 par. 1 nënpar. 1.5. të KPPK-së, Përgjimi i Komunikimeve përmes Rrjetit Kompjuterik parashihet si masë e msheftë teknike e vëzhgimit dhe hetimit, e për aplikimin e së cilës ligji ka paraparë një mori kushtesh dhe procedura që duhet ndjekur, e të cilat procedura kulmojnë me lëshimin e urdhrit për zbatimin e kësaj mase nga gjykata. Meqenëse në rastin konkret këto procedura nuk janë zbatuar dhe këto korrespodenca janë siguruar nga i pandehuri Albert Rakipi, nuk është e ditur nga cila pajisje elektronike janë nxjerrë, e as nuk dihet nëse ka pasur ndonjë ekspertizë lidhur me këtë, duke shtuar faktin se Kodi Penal ka paraparë si vepër të veçantë Hyrjen në rrjetet Kompjuterike të sanksionuar me nenin 339 të KPK-*

së [Kodi Penal NR. 04/L-082], dhe mundësia e manipulimit është potenciale, ngase këtë e mundëson teknologjia informative (për këtë arsye Gjykata në rastin konkret ka menduar se nuk mund të vjen në zbatim Qarkorja e Gjykatës Supreme të Kosovës e datës 12.01.2015 për shkak të specifikës së masës, por edhe rastit konkret). Gjykata ka vlerësuar se një provë e tillë e sjellë nga një i pandehur, e për nxjerrjen e së cilës nevojitet urdhëresë nga gjykata, pasi të jenë respektuar të gjitha procedurat, do të konsiderohej provë thelbësisht e pambështetshme, njëkohësisht kjo paraqet bazë për kundërshtimin e saj".

107. Gjykata Themelore në vijim theksoi se nuk pajtohet me pretendimet e Prokurorisë, e cila ishte pajtuar me leximin e provës. Në këtë kontekst, Gjykata Themelore kishte arsyetuar se "*[...] disponibiliteti i palëve nuk është parim i procedurës penale, por i disa procedurave tjera, dhe në procedurë penale mund të jetë përjashtim atëherë kur parashihet me ligj, ndërsa në rastin konkret për nxjerrjen e një prove të tillë ligji ka paraparë procedura të qarta, për shkak edhe të ndjeshmërisë ndaj lirive dhe të drejtave të njeriut të parapara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ngase nëse pranohen prova të tilla do të cenohej siguria juridike e qytetarëve të Kosovës, ose të atyre që kryejnë vepra në Kosovë".*

108. Gjykata vëren se aktgjykimet e gjykatave të rregullta, në veçanti Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Themelore, si dhe pretendimet e parashtruesit në kërkesën e tij, i referohen edhe Qarkores së Gjykatës Supreme lidhur me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, të 12 janarit 2015, e cila në pikën 3 specifikon:

> *"ÇËSHTJA TJETER DISKUTABILE rezulton të jetë pranueshmëria e provave, siç janë SMS edhe regjistri i numrave të telefonit me të cilët i pandehuri ka komunikuar, të siguruar jashtë këtyre masave. Edhe SMS edhe regjistri i numrave të telefonave, të mbledhura nga prokuroria ose gjykata, jashtë këtyre masave, janë prova të pranueshme.*
>
> *PROKURORI SHTETËROR DHE GJYKATA kanë të drejtë të ndërmarrin çdo veprim procedural, për të siguruar prova relevante për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit (për vërtetimin e fakteve relevante). Në mesin e provave tjera mund të kërkojnë edhe mesazhet telefonike, regjistrin e komunikimeve telefonike edhe komunikimet nëpërmjet internetit etj., pa i aplikuar masat e fshehta teknike dhe të vëzhgimit. MASAT E FSHEHTA TEKNIKE, aplikohen vetëm atëherë kur provat nuk*

mund të sigurohen në ndonjë mënyrë tjetër, dhe nëse provat janë siguruar nëpërmjet këtyre masave, atëherë procedura duhet respektuar maksimalisht, përndryshe, prova rezulton të jetë e papranueshme. PROKURORIA - GJYKATAT, sikurse që kanë të drejtë të kërkojnë p.sh., dokumentacionin e kontabilitetit nga një kompani, për të vërtetuar ndonjë fakt, po ashtu kanë të drejtë të kërkojnë mesazhet telefonike që ka shkëmbyer i pandehuri me personat tjerë, për të vërtetuar ndonjë fakt, dhe këto prova janë të ligjshme dhe të pranueshme."

109. Megjithatë, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Themelore, e cila kishte vlerësuar si në vijim: "*Gjykata Themelore përfundoi arsyetimin e saj duke vlerësuar: "Në pikën kur Prokurorja në fjalën e saj përfundimtare i referohet Qarkores së Gjykatës Supreme të Kosovës e datës 12.01.2015 thotë se kjo qarkore është e bazuar në nenin 88 par. 3, nënpar. 3.2 [Kodi i Procedurës Penale]. Prokurorja përmbajtjen e këtij neni e zhvendos në kontekst të zhdrejtë me atë çfarë ky nen përcakton, ngase ky paragraf është restriktiv për lëshimin e kësaj mase, pra neni ka kërkesë shtesë për zbatuesin e ligjit, ashtu si në pikën 3.1 si standard ka vendosur se për lëshimin e kësaj mase duhet të ekzistojë dyshimi i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerjen e veprës penale, pika 3.2 e këtij neni, përcakton se organet e ndjekjes duhet të argumentojnë se si informacioni të cilin dëshirojnë me masa të fshehta do t'i kontribuoj hetimit, dhe pse informacioni që dëshirojnë ta marrin me masa të mshefta, nuk kanë mundur t'a sigurojnë me veprime tjera hetimore konvencionale (intervistimi i dëshmitarëve, kqyrjen e vendit të ngjarjes etj, me te cilat nuk shkelet privatësia e qytetareve), pra duhet te shtjerrën metodat e tjera të hetimit, dhe si mundësi e fundit mund të kërkohen masat e fshehta, dhe kjo duhet argumentuar para gjykatës".*

110. Gjykata, në vazhdim, rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës, i cili në lidhje me arsyetimin e Gjykatës Themelore ritheksoi se "*[...] si pretekst të papranueshmërisë së email-ave si prova theksojnë se këto prova do të ishin të pranueshme vetëm nëse do të sigurohesh me rastin e aplikimit të masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit. Provat sigurohen në këtë mënyrë vetëm kur Prokuroria e shtetit kërkon sigurimin e tyre, e jo edhe kur i pandehuri vullnetarisht i paraqet komunikimet elektronike për t'u administruar si prova".*

111. Gjykata, vëren se parashtruesi i kërkesës këto pretendime i kishte ngritur edhe përmes ankesave dhe kërkesave të tij për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruara në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, respektivisht.

112. Prandaj, Gjykata rikujton edhe një herë arsyetimin e dhënë në Aktgjykimin e parë [PAKR. nr. 27/2018] të 2 majit 2018 të Gjykatës së Apelit, e cila theksoi se: *"[...] është gjykata ajo që e vlerëson ligjshmërinë e provave dhe sa ato provojnë elementet e veprës penale, shkaktimin e dëmit apo ndonjë çështje me rëndësi. Meqë në rastin konkret kemi të bëjmë me një provë për nxjerrjen e së cilës është dashtë të lëshohet një urdhërese nga gjykata dhe origjina e marrjes së saj nuk dihet [...] kjo Gjykatë vlerëson se me të drejtë Gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar administrimin e kësaj prove".*

113. Në vijim, Gjykata po ashtu rikujton edhe arsyetimin e Gjykatës së Apelit, e cila përmes Aktgjykimit të saj të dytë PAKR nr. 528/2019, të 16 prillit 2019, theksoi se: *"[...] kjo Gjykate arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë i ka mbështet me aktgjykimin PAKR. nr. 27/2018 datë 2 maj 2018 dhe meqë këto konkludime i ka mbështet edhe Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj PML. nr. 238/2018 datë 15.10.2018 kjo Gjykatë nuk do të bëjë vlerësime në ketë drejtim. Pastaj, edhe nën supozimin se këto korrespodenca elektronike janë prova të pranueshme fakti se [J.Q.] ka komunikuar me të akuzuarin [H.V.] rreth ndryshimit të kontratës bazë nuk e liron [parashtruesin e kërkesës] nga përgjegjësia penale sepse është pikërisht ky i akuzuar ai që e ka nënshkruar kontratën e ndryshuar".*

114. Në fund, Gjykata i referohet edhe Aktgjykimit Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019 të Gjykatës Supreme, e cila në riprocedurë vlerësoi se: *"Në rastin konkret del të jetë i pabazuar pretendimi përkitazi me cenimin e barazisë së armëve përkatësisht për mos pranimin e propozimeve të mbrojtjes për leximin e korrespodencës se komunikimeve të realizuara mes të dënuarit [*H.V.*] dhe [zv]drejtorit të "ISD" [J.Q.]. Gjykata e shkallës së parë në faqen e nëntë të aktgjykimit të saj ka arsyetuar faktin se pse nuk u pranua ky propozim i mbrojtjes dhe atë se nuk është e ditur se nga cila pajisje janë nxjerre këto komunikime se nuk ka pasur ekspertizë përkitazi me këto komunikime, dhe për me tepër, për pranimin e këtyre provave nevojitej paraprakisht të kishte urdhër të veçantë nga ana e gjykatës për përgjimin e tyre, andaj, për këtë arsye nuk janë plotësuar kushtet qe këto komunikime të pranohen si prova".*

115. Gjykata, po ashtu, rikujton edhe pretendimin e parashtruesit të kërkesës ku është nënvizuar se "*Është në tërësi konfuz dhe i papranueshëm konkluzioni i Gjykatave te rregullta se edhe sikur të administroheshin si provë komunikimet elektronike epilogu për [parashtruesin e kërkesës] do të ishte i njëjtë. Ky qëndrim është konfuz sepse nuk është e qartë se a konsiderohen email-at si prova të*

papranueshme, apo se Gjykatat e rregullta janë lëshuar në vlerësimin e fuqisë provuese të tyre".

116. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në arsyetimet e tyre për mospranimin e korrespodencës elektronike si provë materiale, ndër të tjera, i janë referuar edhe dispozitave të procedurës penale (nenit 87 të Kodit të Procedurës Penale) në lidhje me aplikimin e masave të fshehta, të cilat, sipas pretendimeve të gjykatave, është dashur të zbatohen në këtë rast. Në lidhje me këtë, Gjykata në linjë me pretendimin apo arsyetimin e parashtruesit të kërkesës vlerëson se dispozitat e procedurës penale përkitazi me masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, ashtu siç është theksuar tashmë nga gjykatat e rregullta, nuk mund të aplikohen në rastin konkret, për arsye se prova e lartcekur në procedurën penale para Gjykatës është propozuar nga parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e të akuzuarit dhe për shkak se korrespodenca elektronike është zhvilluar para procedurës hetimore.

117. Megjithatë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore arsyetimin e saj për refuzimin e korrespodencës elektronike në mes të H.V. dhe J.Q. e mbështet, në thelb, në besueshmërinë e kësaj prove, përkatësisht në mënyrën se si është marrë kjo provë dhe çështjen nëse është kryer ndonjë ekspertizë për marrjen e kësaj prove.

118. Gjykata po ashtu rikujton se korrespodenca elektronike, e propozuar nga parashtruesi i kërkesës si provë materiale, ishte zhvilluar në mes të H.V., i cili në procedurën penale ishte në cilësinë e të akuzuarit dhe J.Q. [zëvendësdrejtorit të kompanisë], i cili nuk ishte palë në procedurë. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet edhe arsyetimit të Gjykatës Themelore, e cila po ashtu vendosi theksin në çështjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, përkatësisht kur në rastin konkret edhe palët tjera përfshihen në korrespodencë, siç është rasti me J.Q..

119. Prandaj, Gjykata vlerëson se arsyetimi i gjykatave të rregullta, dhe në veçanti ai i Gjykatës Themelore në lidhje me mospranimin e provave materiale të propozuara nga parashtruesi i kërkesës, është shumë i qartë dhe i plotë, dhe bazohet edhe në mbrojtjen e të drejtave të palëve të tjera, që garantohen me Kushtetutë dhe me KEDNJ.

120. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se në seancën shqyrtuese para Gjykatës Themelore, J.Q. në cilësinë e dëshmitarit, mes tjerash, kishte ofruar edhe dëshminë e tij në lidhje me korrespodencën elektronike që kishte zhvilluar me H.V., e cila dëshmi ishte reflektuar edhe në Aktgjykimin e kësaj gjykate.

121. Më tej, sa i përket çështjes së administrimit të provave, Gjykata fillimisht thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e GJEDNJ-së *Pronina kundër Rusisë,* kërkesa nr. 65167/01, Vendim për papranueshmëri i 30 qershorit 2005, rastet e Gjykatës KI06/17, parashtrues *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 tetorit 2017, paragrafi 38; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 58).

122. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat në një procedurë para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13071/87, të miratuar më 10 korrik 1991).

123. Gjykata rikujton se e drejta për një *"proces të drejtë"* në procedurat civile dhe penale, e cila kërkohet nga neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi "substanciale" por është drejtësi "procedurale". Në aspektin praktik kjo nënkupton se palët e kanë të drejtën për një procedurë kontradiktore në të cilën merren parasysh parashtresat e palëve dhe në të cilën palët janë të vendosura në pozitë të barabartë para gjykatës (shih rastet e GJEDNJ-së *Star Cate Epilekta Gevmata dhe të tjerët kundër Greqisë*, nr. 54111/07, Vendim i 6 korrikut 2010; dhe shih rastin e Gjykatës KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 prillit 2019, paragrafi 85).

124. Gjykata, në fund, rikujton se parashtruesi i kërkesës, në mbështetje të pretendimeve të tij për shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe atij të kontradiktoritetit iu referua disa rasteve të GJEDNJ-së (të listuara në paragrafin 91). Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në rastet e referuara nga parashtruesi i kërkesës, GJEDNJ në vlerësimin e meritave të kërkesës, kishte përmendur edhe parimet e përgjithshme përkitazi me barazinë e armëve në procedurë, të cilat kjo Gjykatë i kishte zhvilluar dhe i kishte konfirmuar në vazhdimësi në praktikën e saj gjyqësore.

125. Megjithatë, Gjykata vëren se përveç faktit që parashtruesi i kërkesës i është referuar këtyre rasteve në kërkesën e tij, ai në asnjë mënyrë nuk elaboroi lidhshmërinë e tyre, faktike apo juridike, me rrethanat e rastit konkret, detyrë kjo që, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i takon parashtruesit të kërkesës (shih, ndër të tjera, dhe në këtë kontekst, Aktgjykimin në rastin KI48/18 të 4 shkurtit 2019, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës* (LDK), paragrafi 275; dhe rastin KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 majit 2019, paragrafi 80).

126. Në dritën e shqyrtimeve dhe arsyetimeve të lartcekura, Gjykata konkludon se janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit për cenimin e parimit të *"barazisë së armëve"* dhe *"parimit të kontradiktoritetit"*, si rezultat i mospranimit të provës së propozuar nga gjykatat e rregullta.

127. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit se atij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

II. Sa i përket pretendimeve për interpretimin dhe zbatimin qartazi arbitrar për shkak të aplikimit të analogjisë nga gjykatat e rregullta

128. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se *"[...] Gjykatat e rregullta në mënyrë arbitrare i kanë dhënë [parashtruesit të kërkesës], Drejtor Ekzekutiv i një OJQ-je të huaj (të Republikës së Shqipërisë), statusin e personit zyrtarë"*.

129. Parashtruesi i kërkesës fillimisht specifikon se: *"[...] shprehja ligj nënkupton ligjet vendore e jo edhe ato të shteteve të tjera, sepse po të ishte e kundërta, pra që kjo shprehje të nënkuptonte edhe ligjet e shteteve të tjera, atëherë një rrethanë e tillë do të paraqiste "agresion ligjor" të Kosovës në shtetet e tjera. Është më se e qartë se shprehja e përdorur në Kodin Penal "Një person i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të parashikuara me ligj" nënkupton autorizimet që burojnë nga ligjet vendore. Autorizimet të cilat i ka [parashtruesi i kërkesës] në OJQ "ISN" burojnë në ligjet e Republikës së Shqipërisë e jo nga ato të Republikës së Kosovës. Ky fakt vërtetohet edhe nga vet konkluzionet e Gjykatës së Apelit e të cilat përkrahen*

edhe nga Gjykata Supreme ku në mes tjerash thuhet se "Instituti për Studime Ndërkombëtare" është i themeluar në Shqipëri".

130. Së dyti, parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij gjykatat e rregullta kanë *"cenuar parimin e ndalesës së analogjisë"* në të drejtën penale, në atë mënyrë që kanë interpretuar edhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës specifikon se: *"Zbatimi i Ligjit për Prokurim Publik për te dhënë statusin e personit zyrtarë [parashtruesit të kërkesës] është arbitrarë, sepse ky ligj nuk merret fare me përcaktimin e statusit të personave zyrtarë, por përcakton procedurat e prokurimit në tenderët publikë. Edhe sikur Ligji i Prokurimit të përcaktonte domethënien e shprehjes "person zyrtarë" në të drejtën penale është e ndaluar analogjia andaj edhe dispozitat e këtij ligji nuk do të gjenin zbatim, sepse statusin e personit zyrtarë mund ta kenë vetëm personat e përcaktuar në mënyrë taksative në Kodin Penal".*

131. Sipas parashtruesit të kërkesës *"Ndalimi i aplikimit të analogjisë në të drejtën penale është në funksion të sigurisë juridike të subjekteve të së drejtës. Vërehet qartë se në këtë çështje penale Gjykatat e rregullta e kanë shkelur këtë parim. Ndalesa e analogjisë taksativisht është parashikuar me nenin 1 par 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës sipas të cilit: "Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi në bazë të analogjisë".*

132. Në kontekst të kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi pretendimin e tij për interpretim dhe zbatim qartazi arbitrar të ligjit nga gjykatat e rregullta e bazon në të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, Gjykata duke u bazuar në faktet e pretenduara dhe provat e bashkëngjituara në kërkesë, pretendimin e parashtruesit të kërkesës, i cili në mënyrë specifike i referohet cilësimit të tij si person zyrtar, do ta vlerësojë në kontekst të asaj nëse pretendimi i tij i ngritur para gjykatave të rregullta është adresuar në mënyrë të mjaftueshme nga Gjykata Supreme, në pajtueshmëri me të drejtën për një vendim te arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih në mënyrë të ngjashme rastin KI145/18, parashtrues *Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahimi*, të cituar më lart, paragrafi 39).

133. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës, ku është përcaktuar që: "Një ankese është e karakterizuar nga faktet e pretenduara në të dhe jo thjesht nga bazat ligjore apo argumentet në të cilat mbështetet" (shih rastin e GJEDNJ-

së, Stefanica dhe të tjerët kundër Rumanisë, Aktgjykimi i 2 nëntorit 2010, paragrafi 23; shih edhe rastet e Gjykatës, KI145/18, parashtrues Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahimi, Aktgjykim, i 19 korrikut 2018, paragrafi 35, KI34/17, parashtruese e kërkesës Valdete Daka, Aktgjykim, i 1 qershorit 2017, paragrafi 83 dhe KO73/16, parashtruesi i kërkesës Avokati i Popullit, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative Nr. 1/2016 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës me 21 janar 2016, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 78).

134. Rrjedhimisht, Gjykata do të shqyrtojë dhe vlerësojë kushtetutshmërinë e pretendimit të parashtruesit të kërkesës duke iu referuar parimeve të përgjithshme përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, shqyrtim ky në të cilin, Gjykata fillimisht (i) do të i shtjellojë parimet e përgjithshme; dhe me pas, (ii) do të i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(i) Parimet e përgjithshme sipas praktikës së Gjykatës dhe asaj të GEJDNJ-së përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor

135. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; Buzescu kundër Rumanisë, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe T*atishvili kundër Rusis*ë, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj,* Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic,* Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17,

parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverbrand*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019).

136. Në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, H. kundër Belgjikës, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53). Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar me të vërtetë, dhe për pasojë kontribuon në një pranueshmëri më të madhe të vendimeve (shih, rastin e GJEDNJ-së Magnin kundër Francës, Vendim i 10 majit 2012, paragrafi 29). Kjo praktikë gjyqësore gjithashtu përcakton se përkundër faktit që një gjykatë ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë aktivitetet dhe vendimmarrjen e saj duke dhënë arsyet përkatëse (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Suominen kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 36; *Carmel Saliba kundër Maltës*, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73). Për më tepër, vendimet duhet të jenë të arsyetuara në atë mënyrë që t'u mundësojë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GJEDNJ *Hirvisaari kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 30).

137. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih rastet e GJEDNJ-*së Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Morerira Ferreira kundër Portugalisë*, të cituar më lart, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty).

138. Në fund, Gjykata duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore rikujton se vendimet e gjykatave do të shkelin parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI72/12, parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, cituar më lart, paragrafi 61; KI135/14, parashtrues *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI87/18, parashtrues *IF Skadeforsikring* cituar më lart, paragrafi 49).

(ii) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin e parashtruesit të kërkesës*

139. Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me cilësimin e tij si person zyrtar është adresuar nga Gjykata Supreme në mënyrën e duhur dhe në pajtueshmëri me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, ashtu sic garantohet me nenin 31 të Kushteutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

140. Gjykata rikujton se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës, në thelb pretendon se gjykatat e rregullta, përfshirë edhe Gjykatën Supreme gjatë nxjerrjes së vendimeve të tyre përmes të cilave ai ishte cilësuar me statusin e personit zyrtar në bazë të analogjisë kishin aplikuar edhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës kishte ritheksuar dhe specifikuar se ai nuk kishte status të personit zyrtar ashtu siç specifikohet me nenin 107 të Kodit të Përkohshëm Penal.

141. Në këtë kontekst, Gjykata në mënyrë që të vlerësojë kushtetutshmërinë e pretendimit të parashtruesit të kërkesës, së pari i referohet Aktgjykimit PKR.nr.432/15, të 18 dhjetorit 2017 të Gjykatës Themelore, përmes së cilit parashtruesi i kërkesës ishte cilësuar me statusin e personit zyrtar dhe rrjedhimisht ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale nga neni 341 [Mashtrimi në detyrë], paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të Kodit të Përkohshëm Penal, i cili përcakton:

> *1. Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër bën*

prezentimin e rremë të raportit të llogarive apo i cili në mënyrë tjetër e vë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës së kundërligjshme dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

[...]

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon 5.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

142. Gjykata, në vijim rikujton se Gjykata Themelore duke iu referuar "Deklaratës nën Betim", të dhënë nga parashtruesi i kërkesës, deklaratë e cila ishte pjesë e dokumentacionit tenderues, kishte vërtetuar se parashtruesi i kërkesës *"[...] ka përfaqësuar Institutin si person zyrtar, ngase ka vepruar si organizatë biznesi-person juridik, sepse sipas Ligjit për Prokurimit Publik respektivisht dispozitës së nenit 61 [Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve] të nenit të përmendur, ka ushtruar detyra të posaçme, që lidhen me aktivitetin e prokurimit publik".*

143. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se vetë *"Deklarata nën Betim"* nuk është pjesë e Ligjit për Prokurimin Publik, por është nxjerrë nga dispozita e nenit 61 të Ligjit për Prokurimin Publik.

144. Gjykata më tej rikujton, se parashtruesi i kërkesës pretendimin e tij se nuk e kishte statusin e personit zyrtar e kishte ngritur edhe përmes ankesave të tij, të parashtruara në Gjykatën e Apelit dhe kërkesave të tij për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruara në Gjykatën Supreme. Prandaj, në kontekst të pretendimve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata në vijim do t'i referohet edhe arsyetimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit dhe atyre nga Gjykata Supreme.

145. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit PAKR nr. 27/2018, të 2 majit 2018 në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se ai nuk e ka statusin e personit zyrtar, vlerësoi se Gjykata Themelore kishte dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat arsye *"[...] i aprovon edhe kjo Gjykatë dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësime." Rrjedhimisht,* Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit vëretetoi interpretimin e dhënë nga Gjykata Themelore se parashtruesi i kërkesës kishte statusin e *"personit zyrtar".*

146. Në vijim, Gjykata rikujton se në procedurën e rigjykimit në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit në Aktgjykimin e saj PAKR nr. 528/2019, të 16

prillit 2019, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se ai nuk e ka statusin e *"personit zyrtar"*, vlerësoi se:

> *"[...] qëndron fakti se [parashtruesi i kërkesës] është shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe se Instituti për Studime Ndërkombëtare të cilën e përfaqëson i akuzuari është i themeluar ne Shqipëri, por nga ky fakt nuk mund te konkludohet se ky i akuzuar në rastin konkret nuk e ka cilësinë e personit zyrtar. Sepse, sipas Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës nr. 2003/17 ky Institut si palë e interesuar ka ofertuar në Kosovë si operator ekonomik (ka ofruar shërbime respektivisht ka kontraktuar punë) dhe [parashtruesi i kërkesës] përveç që e përfaqëson Institutin si person zyrtar me rastin e fitimit te tenderit nga autoriteti kontraktues (Universiteti i Prishtinës) ka marrë përsipër ushtrimin e detyrave të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj."*

147. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj të dytë përkitazi me parashtruesin e kërkesës interpretoi nocionin *"person zyrtar"* duke iu referuar edhe Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 2003/17, pa dhënë arsyetim specifik se në bazë të cilit paragraf të nenit 107 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, parashtruesi i kërkesës, si person juridik, e ka statusin e *"personit zyrtar", gjegjësisht nuk specifikoi se* ***"cilin funksion publik ose cilin autoritet publik kishte ushtruar parashtruesi i kërkesës në mënyrë që të konsiderohet person zyrtar"***. Në fakt, Gjykata e Apelit në fund vetëm konkuldoi se *"... nuk mund të konkludohet se ky i akuzuari në rastin konkret* ***nuk e ka cilësinë e personit zyrtar****"*.

148. Gjykata, në vijim rikujton pretendimin specifik të parashtruesit të kërkesës të ngritur në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, përmes së cilës kërkesë theksoi se:

> *"Parashtruesi është dënuar për veprën penale nga neni 341 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës "mashtrim në detyrë". Mashtrimi në Detyrë mund të kryhet vetëm nga "personi zyrtar". Duke e marre parasysh faktin se OJQ "ISN" (Republika e Shqipërisë) ka qene në marrëdhënie kontraktuale me Universitetin e Prishtinës, pyetjet e radhës të cilat duhet të adresohen janë:*
>
> > *a. Nëse secilit operatore ekonomik duhet t'i ipet statusi i "personit zyrtar" sipas kodit të përkohshëm penal, si dhe:*

b. A ka mundësi qe të këtë statusin e personit zyrtar personi përgjegjës i një OJQ-je të huaj e cila nuk është e regjistruar në Republikën e Kosovës."

149. Në kontekst të këtij pretendimi specifik, Gjykata rikujton arsyetimin e dhënë nga Gjykata Supreme, e cila në Aktgjykimin e saj të kontestuar Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, theksoi se: *"[...] vepra penale në fjalë mund te kryhet ekskluzivisht nga personi zyrtar dhe me këtë rast gjykatat e instancave më të ulëta e kanë potencuar në vendimet e tyre faktin se [parashtruesi i kërkesës] kishte këtë cilësi, dhe për më tepër, kanë cituar dispozitat ligjore që përcaktojnë cilësinë e personit zyrtar edhe pse behet fjale për shtetas te Republikës se Shqipërisë dhe organizata "ISD" po ashtu kishte selinë në Tiranë, megjithatë nuk kishte dyshime se i dënuari kishte cilësinë e personit zyrtar pasi qe përveç faktit se ishte përfaqësues i "ISD-së" dhe kishte ofertuar ne Kosove si përfaqësues i operatorit ekonomik, kishte marre për sipër ushtrimin e posaçëm të detyrave zyrtare në baze të autorizimit ligjor siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 107 te KPPK-së [Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës]"*.

150. Duke u bazuar në Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se kjo e fundit në lidhje me cilësimin e parashtruesit të kërkesës si "personi zyrtar", kishte vërtetuar interepretimet e gjykatave të shkallës më të ulët duke konstatuar se "[parashtruesi i kërkesës] *kishte marre për sipër ushtrimin e posaçëm të detyrave zyrtare në baze të autorizimit ligjor siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 107 te KPPK-së [Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës]"*. Megjithatë nuk kishte specifikuar se cili paragraf i nenit 107 i KPPK-së është i aplikueshëm në rastin e tij, dhe po ashtu nuk kishte specifikuar se cili ishte autoriteti publik, dhe detyrat e posaçme të cilat ai i ushtronte brenda këtij autoriteti.

151. Në këtë aspekt, Gjykata përsërit se GJEDNJ, ndër të tjera, në Aktgjykimin Hadjianastassiou kundër Greqisë, cituar me lart, mori qëndrimin se gjykatat vendore duhet "të shpjegojë në menyrë mjaft të qartë se mbi cilat baza juridike e bazon vendimin e saj" (shih, në këtë kontekst, gjithashtu rastin e Gjykatës KI87/18 parashtrues *IF Skadeforsikring,* cituar me lart, paragrafi 61).

152. Tutje, Gjykata vëren se një arsyetim i mjaftueshëm dhe i qartë në lidhje me statusin e "personit zyrtar" nuk iu dha parashtruesit të kërkesës në asnjë prej aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, përkundrazi, statusi i tij çdoherë është konstatuar me përdorimin e analogjisë bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik nr. 2003/17, duke mos arsyetuar me asnjë fjalë të vetme se në bazë të cilit paragraf të

nenit 107 të Kodit të Përkohshëm Penal parashtruesi i kërkesës e ka cilësinë e personit zyrtar.

153. Sikur Gjykata Supreme të adresonte pretendimin thelbësor të parashtruesit të kërkesës për kualifikimin e tij si person zyrtar pavarësisht përgjigjes që do t'i jepej këtij pretendimi (pra, pavarësisht nëse ky pretendim do të pranohej si i arsyetuar apo do të refuzohej si i pabazë), atëherë do të përmbushej kushti i "palës së dëgjuar" dhe i administrimit të duhur të drejtësisë (shih, mutatis mutandis, rastin e Gjykatës KI145/18, të cituar më lart, paragrafi 58).

154. Në këtë drejtim, Gjykata vë në pah se nuk është në detyrën e Gjykatës Kushtetuese të ekzaminojë deri në çfarë mase janë të arsyeshme pretendimet e parashtruesve në procedurat pranë gjykatave të rregullta. Megjithatë, drejtësia procedurale e kërkon që pretendimeve thelbësore të ngritura nga palët në gjykatat e rregullta duhet dhëne përgjigje në mënyrën e duhur - posaçërisht nëse kanë të bëjnë me interpretimin ligjor që i referohet kualifikimit të parashtruesit të kërkesës si person zyrtar e që drejtpërdrejt ndikon edhe në cilësimin e veprës penale për të cilin ai është shpallur fajtor.

155. Gjykata ripërsëritë se parashtruesi i kërkesës, si para gjykatave të shkallës më të ultë, ashtu edhe para Gjykatës Supreme, kishte ngritur çështjen e interpretimit dhe aplikimit në bazë të analogjisë të Ligjit për Prokurimin Publik. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar më 12 qershor 2019, po ashtu në mënyrë specifike pretendoi se "*Zbatimi i Ligjit për Prokurim Publik për të dhënë statusin e personit zyrtarë [të parashtruesit të kërkesës] është arbitrarë, sepse ky ligj nuk merret fare me përcaktimin e statusit të personave zyrtarë, por përcakton procedurat e prokurimit në tenderët publikë. Edhe sikur Ligji i Prokurimit të përcaktonte domethënien e shprehjes "person zyrtarë" në të drejtën penale është e ndaluar analogjia andaj edhe dispozitat e këtij ligji nuk do të gjenin zbatim, sepse statusin e personit zyrtarë mund ta kenë vetëm personat e përcaktuar në mënyrë taksative në Kodin Penal. Ndalimi i aplikimit te analogjisë në të drejtën penale është në funksion të sigurisë juridike të subjekteve të së drejtës. Vërehet qartë se në këtë çështje penale Gjykata e Apelit e ka shkelur këtë parim. Ndalesa e analogjisë taksativisht është parashikuar me nenin 1 par 3 te Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës sipas të cilit: "Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi në bazë të analogjisë*".

156. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata konstaton se janë të bazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Ligji për Prokurimin Publik nuk ofron përkufizimin e *"personit zyrtar"*, megjithatë, kjo Gjykatë rithekson se gjykatat e rregullta në vendimet e tyre i janë referuar këtij ligji për të arsyetuar se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e përfaqësuesit të kompanisë, kishte ofruar shërbime si operator ekonomik për nevoja të një autoriteti publik.

157. Prandaj, duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme vërtetoi qëndrimin e gjykatave të rregullta, pa u përgjigjur në pretendimin specifik të parashtruesit të kërkesës në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Ligjit për Prokurimin Publik, në të cilin rast, si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës ishte cilësuar si person zyrtar.

158. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se Aktgjykimi i kontestuar [Pml. nr. 253/2019] i Gjykatës Supreme, i 30 shtatorit 2019 nuk i ka plotësuar kriteret për një vendim të aryetuar gjyqësor si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse ka dështuar që në mënyrë të mjaftueshme të adresojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës kur ka vërtetuar vendimet e gjykatave të rregullta, përmes së cilave ai ishte cilësuar me statusin e personit zyrtar.

159. Gjykata rithekson se ky përfundim ka të bëjë ekskluzivisht me aktgjykimet e kontestuara nga pikëpamja e interpretimit të ligjit, në mënyrë specifike arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata Supreme në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit të tij në rivendosje. Gjykata thekson se nuk është e thirrur të vendosë për përgjegjësinë individuale penale të parashtruesit të kërkesës, që në rend të parë është çështje e vlerësimit të gjykatave të rregullta (shih Aktgjykimin *Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë,* kërkesat nr. 34044/96, 35532/97 dhe 44801/98, të 22 marsit 2001, paragrafi 51). Në këtë kontekst, Gjykata thekson se konstatimi i saj se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të së drejtës së parashtruesit për vendim të arsyetuar gjyqësor, i referohet në mënyrë specifike vetëm pretendimit të ngritur nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij në Gjykatë.

Përfundime

160. Gjykata ka trajtuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kerkesës, duke aplikuar mbi këtë vlerësim praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe

GJEDNJ-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atij të barazisë së armëve dhe mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, parime dhe garanci këto që janë të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

161. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për cenim të parimit të "barazisë së armëve" dhe "parimit të kontradiktoritetit" si rezultat i mospranimit të provës së propozuar nga gjykatat e rregullta, Gjykata konstatoi se janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se atij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

162. Sa i përket mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata konstatoi se me nxjerren e Aktgjykimit Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, Gjykata Supreme ka dështuar të arsyetojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe nuk e ka arsyetuar vendimin e saj përkitazi me cilësimin e tij si person zyrtar.

Kërkesa për seancë dëgjimore

163. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore.

164. Gjykata rikujton se rregulli 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] paragrafi (2) i Rregullores së punës përcakton që *"Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit"*.

165. Gjykata vëren se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ky rregull vetëm parasheh mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo të ligjit. Pra, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo konsideron se të dhënat ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur tek një vendim meritor lidhur me rastin që është në shqyrtim (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI34/17, parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110 - ku thuhet se "*Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur në rast [...]*").

166. Në rastin konkret, Gjykata ka pasur qasje në dosjen origjinale të rastit dhe në të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, prandaj Gjykata nuk konsideron se ekziston ndonjë paqartësi rreth *"provave apo ligjit"* dhe

për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur përkitazi me kërkesën e parashtruesit.

167. Rrjedhimisht, Gjykata, njëzëri, e refuzon kërkesën e parashtruesit të kërkesës për caktim të seancës dëgjimore si të pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 dhjetor 2020.

VENDOS

I. TË DEKLAROJË, me shumicë votash, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i mos arsyetimit të vendimit gjyqësor përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për cilësimin e tij si person zyrtar;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019 përkitazi me parashtruesin e kërkesës;

IV. TË KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, për rivendosje në pajtim me konstatimet të këtij Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese;

V. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën Kushtetuese, sa më shpejtë që është e mundur, por jo më vonë se me 30 prill 2021 lidhur për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës;

VI. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të këtij Aktgjykimi;

VII. TË REFUZOJË njëzëri kërkesën e parashtruesit për mbajtje të seancës dëgjimore;

VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, ne pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë të njëjtin në Gazetën Zyrtare;

IX. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Radomir Laban	Arta Rama-Hajrizi

MENDIM I PËRBASHKËT KONKURRUES

i gjyqtarëve,

Bajram Ljatifi, Safet Hoxha dhe Radomir Laban
në
rastin nr. KI230/19

Parashtrues

Albert Rakipi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019

Duke shprehur në fillim respektin dhe pajtimin tonë me mendimin e shumicës së gjyqtarëve se në këtë rast ka shkelje të nenit 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), konsiderojmë se ekziston edhe një shkelje tjetër e të drejtave të njeriut e kryer ndaj parashtruesit të kërkesës, e cila ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së, të cilën do ta arsyetojmë në vazhdim.

Arsyetimi i Mendimit të përbashkët konkurrues

1. Në fillim rikujtojmë se parashtruesi i kërkesës pretendon se *"[...] Gjykatat e rregullta në mënyrë arbitrare i kanë dhënë [parashtruesit të kërkesës], Drejtor Ekzekutiv i një OJQ-je të huaj (të Republikës së Shqipërisë), statusin e personit zyrtarë."*

2. Parashtruesi i kërkesës fillimisht specifikon se: *"[...] shprehja ligj nënkupton ligjet vendore e jo edhe ato të shteteve të tjera, sepse po të ishte e kundërta, pra që kjo shprehje të nënkuptonte edhe ligjet e shteteve të tjera, atëherë një rrethanë e tillë do të paraqiste "agresion ligjor" të Kosovës në shtetet e tjera. Është më se e qartë se shprehja e përdorur në Kodin Penal "Një person i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të parashikuara me ligj" nënkupton autorizimet që burojnë nga ligjet vendore. Autorizimet të cilat i ka*

[parashtruesi i kërkesës] në OJQ "ISN" burojnë në ligjet e Republikës së Shqipërisë e jo nga ato të Republikës së Kosovës. Ky fakt vërtetohet edhe nga vet konkluzionet e Gjykatës së Apelit e të cilat përkrahen edhe nga Gjykata Supreme ku në mes tjerash thuhet se "Instituti për Studime Ndërkombëtare" është i themeluar në Shqipëri."

3. Së dyti, parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij gjykatat e rregullta kanë *"cenuar parimin e ndalesës së analogjisë"* në të drejtën penale, në atë mënyrë që kanë interpretuar edhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës specifikon se: *"Zbatimi i Ligjit për Prokurim Publik për te dhënë statusin e personit zyrtarë [parashtruesit të kërkesës] është arbitrarë, sepse ky ligj nuk merret fare me përcaktimin e statusit të personave zyrtarë, por përcakton procedurat e prokurimit në tenderët publikë. Edhe sikur Ligji i Prokurimit të përcaktonte domethënien e shprehjes "person zyrtarë" në të drejtën penale është e ndaluar analogjia andaj edhe dispozitat e këtij ligji nuk do të gjenin zbatim, sepse statusin e personit zyrtarë mund ta kenë vetëm personat e përcaktuar në mënyrë taksative në Kodin Penal."*

4. Sipas parashtruesit të kërkesës: *"Ndalimi i aplikimit të analogjisë në të drejtën penale është në funksion të sigurisë juridike të subjekteve të së drejtës. Vërehet qartë se në këtë çështje penale Gjykatat e rregullta e kanë shkelur këtë parim. Ndalesa e analogjisë taksativisht është parashikuar me nenin 1 par 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës sipas të cilit: "Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi në bazë të analogjisë"."*

5. Sa i përket pretendimeve të lartcekura të parashtruesit të kërkesës, ne konsiderojmë se në dritën e rrethanave të rastit konkret duhet të vlerësohet kushtetutshmëria e pretendimeve të parashtruesit për interpretimin dhe zbatimin qartazi arbitrar të ligjit për shkak të aplikimit të analogjisë nga gjykatat e rregullta. Në kontekst të kësaj, vërejmë se pretendimin e tij për interpretimin dhe zbatimin qartazi arbitrar të ligjit, parashtruesi i kërkesës e bazon në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, ne vërejmë se vetë thelbi i pretendimeve të parashtruesit për "*ndalimin e aplikimit të analogjisë në të drejtën penale*" që hyn në kuadër të së drejtës së garantuar me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së si dhe zbatimi i saj, janë interpretuar gjerësisht në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

6. Në këtë aspekt, rikujtojmë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe atë të Gjykatës, ku është përcaktuar që: *"Një ankese është e karakterizuar nga faktet e pretenduara në të dhe jo thjesht nga bazat ligjore apo argumentet në të cilat mbështetet*" (shih rastin e GJEDNJ-së, *Stefanica dhe të tjerët kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 2 nëntorit 2010, paragrafi 23; shih edhe rastet e Gjykatës, KI145/18, parashtrues *Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahimi*, Aktgjykim i 19 korrikut 2018, paragrafi 35, KI34/17, parashtruese e kërkesës *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafi 83 dhe KO73/16, parashtruesi i kërkesës *Avokati i Popullit*, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative Nr. 1/2016 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës më 21 janar 2016, Aktgjykim i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 78).

7. Prandaj, në dritën e arsyetimit si më lart, konsiderojmë se pretendimet e parashtruesit të kërkesës duhet të shqyrtohen duke u mbështetur në faktet e pretenduara dhe provat e bashkëngjitura në kërkesë, për t'iu përgjigjur pretendimit të parashtruesit të kërkesës përkitazi me *"ndalimin e aplikimit të analogjisë në të drejtën penale"* (shih në mënyrë të ngjashme rastin KI145/18, parashtrues *Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahimi,* të cituar më lart, paragrafi 36).

8. Rrjedhimisht, duhet të vlerësohet kushtetutshmëria e pretendimit të parashtruesit të kërkesës për interpretimin dhe zbatimin arbitrar të ligjit si rezultat i përdorimit të analogjisë, duke iu referuar parimeve përkitazi me "*parimin e legalitetit"* dhe "*ndalimin e aplikimit të analogjisë në të drejtën penale*" të mishëruara në nenin 33 të Kushtetutës, nenin 7 të KEDNJ-së, dhe në praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së.

9. Në kontekst të kësaj, gjatë arsyetimit të Mendimit konkurrues, do të elaborojmë së pari **a)** Parimin e legalitetit – limitin për aplikimin e analogjisë në të drejtën penale, **b)** Justifikimin dhe fushën e vlefshmërisë së ndalimit të analogjisë në të drejtën penale materiale, për të vazhduar me elaborimin e **c)** Analogjisë ligjore në të drejtën penale, në lidhje me "*parimin e legalitetit"* dhe "*ndalimin e aplikimit të analogjisë në të drejtën penale",* që garantohen me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së.

10. Në fund të arsyetimit të Mendimit konkurrues do t'i elaborojmë parimet e përgjithshme përkitazi me ndalimin e aplikimit të analogjisë në të drejtën penale, të vendosura me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe do t'i zbatojmë këto parime në rrethanat faktike dhe juridike të

rastit konkret, përkatësisht në rastin e parashtruesit të kërkesës dhe pas kësaj, në bazë të të njëjtave, do të paraqesim mendimin tonë lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara.

a) Parimi i legalitetit - limiti për aplikimin e analogjisë në të drejtën penale

11. Për dallim nga degët e tjera të së drejtës, aplikimi i analogjisë si një formë e interpretimit logjik të normave penalo-juridike është *"reduktuar në minimum"* për shkak të vlefshmërisë së parimit të legalitetit: *nullum crimen, nulla poena sine lege*. Në të drejtën penale materiale, parimi i legalitetit është i paprekshëm – ai përcakton kufijtë e interpretimit të ligjit penal në përgjithësi, por edhe të interpretimit logjik përmes argumentit të analogjisë.

12. Për të kuptuar se në çfarë mënyre dhe në çfarë mase parimi i legalitetit është pengesë për aplikimin e analogjisë në të drejtën penale materiale, duhet të tregohet efekti i tij në përgjithësi dhe ndikimi i tij në përcaktimin e kufijve të interpretimit të normave penalo-juridike.

13. Parimi i legalitetit ka efekt të shumëfishtë dhe pasqyrohet në këto çështje: (1) vetëm ligji mund të jetë burim i së drejtës penale *(nullum crimen sine lege scripta)*, duke përjashtuar kështu zbatimin e së drejtës zakonore; (2) është përjashtuar krijimi i inkriminimeve të reja me anë të analogjisë *(nullum crimen sine lege stricta)*; (3) është i zbatueshëm vetëm ligji i cili është në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale: *nullum crimen, nulla poena sine lege* (kjo kërkesë në teori njihet edhe si parim i ndalimit të veprimit retroaktiv të ligjit penal *(nullum crimen sine lege praevia))*; (4) përshkrimet e figurave të veprave penale në normat ligjore duhet të jenë të qarta dhe precize. Ky parim i ligjshmërisë i kuptuar në këtë mënyrë siguron funksionin e garantuar të së drejtës penale – mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

14. Me efektin e tij, *"parimi i legalitetit"* përcakton edhe kufijtë e interpretimit të normave penale. Së pari, për shkak të vlefshmërisë së këtij parimi, në veçanti është e shprehur kërkesa që teksti ligjor paraqet fillimin dhe bazën e secilit interpretim. Besnikëria ndaj tekstit ligjor e sjell interpretimin deri në kuptimin e vërtetë dhe kufijtë e ligjit – që sa më shumë të respektohet, e sa më pak të largohemi nga ai.

15. Specifika tjetër e interpretimit të inkriminimeve lidhet me funksionin themelor të së drejtës penale – mbrojtjen e vlerave të caktuara, e cila nuk duhet të lihet pas dore gjatë secilit interpretim. Përcaktimi i objektit mbrojtës është parakusht themelor për interpretimin e saktë

të ligjit penal. Duke zbuluar objektin e mbrojtjes mësojmë se çfarë ligjvënësi dëshiron të mbrojë me një normë të caktuar penale, cili është qëllimi i saj. Me këtë njohje të objektit të mbrojtjes, kuptimi dhe domethënia e vërtetë e normës e cila interpretohet, bëhen të qartë. Prandaj, ky interpretim sipas objektit të mbrojtjes është një tipar i veçantë i interpretimit teleologjik në të drejtën penale. Krahas objektit, për interpretimin e ligjit penal është e rëndësishme edhe shtrirja e mbrojtjes penalo-juridike. Karakteri fragmentar, parcial i mbrojtjes penalo-juridike përcakton kufijtë deri ku mund të shkohet gjatë interpretimit: për përcaktimin e kuptimit të vërtetë të normës, duhet të dihet deri në çfarë mase norma e cila interpretohet ofron mbrojtje për një të mirë (e mira e mbrojtur nuk gëzon mbrojtje penalo-juridike nga të gjitha sulmet, por vetëm nga disa, sipas rregullit, nga ato më të rënda). Për përcaktimin e raportit ndërmjet figurave ligjore të veprave të caktuara penale, sidomos të atyre që janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, është e rëndësishme edhe lartësia e dënimit të paraparë. Në fund, është i ndaluar çdo interpretim në kundërshtim me thelbin dhe qëllimin e parimit të legalitetit në të drejtën penale, si garantuesin e sigurisë juridike në interpretimin e ligjit penal.

16. Interpretimi i paraqitur i kufijve të aplikimit të analogjisë dominon në legjislacionet bashkëkohore penale, dhe nëse merren parasysh zhvillimi i përgjithshëm historik të së drejtës penale dhe zgjidhjet individuale në të drejtën krahasuese, mund të konkludohet se ligjvënësit kanë ose kanë pasur qëndrime të ndryshme në lidhje me këtë çështje: (1) se analogjia është shprehimisht e ndaluar, por një procedurë e tillë legjislative është shumë e rrallë; (2) se nuk ekziston ndalimi eksplicit, por përcaktohet parimi i legalitetit, kështu që nga përmbajtja e përcaktuar dhe diksioni i normës në lidhje me këtë parim të paprekshëm, rezulton se analogjia është e ndaluar; (3) se me vendosjen e të ashtuquajturave "klauzola të përgjithshme" në dispozicionin e normës penalo-juridike në dispozitat e caktuara parashikohet analogjia *intra legem*; (4) se analogjia ligjore apo juridike ose të dyja së bashku, njihen nga legjislacioni përkatës si një institut i përgjithshëm juridik.

b) Justifikimi dhe fusha e vlefshmërisë së ndalimit të analogjisë në të drejtën penale materiale

17. Me anë të rregulloreve penalo-juridike mbrohen të mirat më të rëndësishme të njerëzve dhe për shkeljen e tyre përcaktohen sanksionet më të rënda, kështu që vlefshmëria e paprekshme e parimit të ligjshmërisë paraqitet si e domosdoshme për të siguruar sigurinë juridike të qytetarëve. Kjo është arsyeja kryesore për të ndaluar analogjinë në të drejtën penale, si një mjet për krijimin e veprave të

reja penale, pasi që është drejtpërdrejt në kundërshtim me kuptimin dhe funksionin e këtij parimi themelor të së drejtës penale.

18. Një analogji e tillë është e ndaluar edhe në të drejtën tonë penale. Nuk lejohet që një gjykatë të cilësojë një veprim si vepër penale, në qoftë se ky veprim nuk parashikohet në ligjin penal si vepër penale, edhe pse është i ngjashëm me një vepër penale të parashikuar me ligj. Një ndalesë e tillë parashikohet shprehimisht me Kodin e Përkohshëm Penal [Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25] i cili në nenin 1 - Parimi i ligjshmërisë, parashikon:

> *3. Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit i cili hetohet, ndiqet ose shpallet fajtor.*

19. Parimi i legalitetit është ngritur në rangun e parimit kushtetues dhe vlen për të gjitha veprat penale dhe rregullohet në dispozitat për të drejtën e sigurisë juridike në të drejtën penale (neni 33 par. 1 i Kushtetutës). Nga garancia se nuk ka vepër penale dhe dënim pa ligj, e cila njihet si parim i përcaktueshmërisë së veprës dhe dënimit në ligj, duke zbatuar rregullin *argumentum a contrario*, si një formë e interpretimit logjik, konkludohet se vepra penale dhe dënimi nuk mund të përcaktohen me anë të normës jashtë ligjit, domethënë as me normën e cila lind në procesin e krijimit të së drejtës nëpërmes aplikimit të analogjisë.

20. Pra, është e ndaluar analogjia me të cilën krijohen veprat e reja penale: sjellja e njeriut, sado e rrezikshme dhe e dëmshme është për shoqërinë, nuk mund të cilësohet si vepër penale nëse nuk është e parashikuar me ligj si vepër penale. Një analogji e tillë përjashtohet nga e drejta penale si drejtpërdrejt e kundërt me parimin e legalitetit sepse krijon pasigurinë juridike dhe mundëson autokracinë, arbitraritetin dhe keqpërdorimet nga organet gjyqësore.

21. Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut nga çdo arbitraritet dhe nga keqpërdoret e mundshme nga ana e gjykatës paraqet pikërisht motivin vendimtar për ndalimin e analogjisë me të cilën krijohet një vepër e re penale, madje edhe nëse është e ngjashme me një nga veprat penale të parashikuara me ligj. Thënë shkurtimisht, kuptimi dhe funksioni i parimit të legalitetit përcaktojnë shtrirjen e vlefshmërisë, kufijtë dhe zonën e ndaluar të analogjisë në të drejtën penale.

22. Duke u nisur nga qëllimi dhe kufijtë e ndalimit të analogjisë të përcaktuar në këtë mënyrë, në rastet penalo-juridike konsiderohet se ndalimi përfshin në veçanti:

a) ndalimin e analogjisë me të cilën krijohet një vepër e re penale duke zbatuar rregulloret penale me të cilat rregullohet rasti më i ngjashëm (p.sh. në qoftë se një sjellje e cila në ligj nuk parashikohet si penale, cilësohet nga gjykata si vepër penale përmes zbatimit të dispozitës ligjore me të cilën një sjellje shumë e ngjashme është inkriminuar si vepër penale);
b) ndalimin që me anë të analogjisë të krijohen format e reja të kualifikuara të një vepre themelore penale (p.sh. duke deklaruar si kualifikuese një rrethanë e cila si e tillë nuk është parashikuar te kjo vepër penale, por është e njëjtë ose e ngjashme me një rrethanë kualifikuese e parashikuar te një vepër tjetër penale e cila është e ngjashme apo e përafërt;
c) ndalimin që dënimi të ashpërsohet përmes interpretimit sipas analogjisë; dhe
d) ndalimin e analogjisë juridike, përkatësisht ndalimin që vepra penale ose dënimi të krijohet me një normë individuale juridike në bazë të parimeve të përgjithshme të legjislacionit penal apo frymës së rendit juridik në përgjithësi.

23. Në të gjitha këto raste, përmes aplikimit të analogjisë, ligji ndryshohet dhe plotësohet në dëm të të pandehurit, gjë që është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimin e ligjshmërisë në të drejtën penale dhe si rrjedhojë këto raste ndodhen në zonën e analogjisë së ndaluar.

c) Analogjia ligjore në të drejtën penale

24. Legjislacionet bashkëkohore penale nuk parashikojnë shprehimisht aplikimin e analogjisë ligjore, por konsiderohet se analogjia ligjore nuk është e ndaluar në tërësi dhe se aplikimi i saj megjithatë është i mundur në fushën e interpretimit dhe zbatimit të rregulloreve penale, brenda kufijve të caktuar me parimin e legalitetit. Me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve të munguara në ligj, lejohet aplikimi i analogjisë ligjore nëse kjo shkon në favor të të pandehurit dhe nuk është në kundërshtim me rregulloret e tjera penale dhe parimet penalo-juridike. Për shembull, gjykata mund të shërbehet me një analogji të tillë, në veçanti në materien për përjashtimin e kundërligjshmërisë, pasi që kjo fushë në pjesën më të madhe nuk është rregulluar sa duhet.

25. Për aplikimin e analogjisë ligjore angazhohen edhe në fushat e tjera penalo-juridike. Ekzistojnë mendime se ky lloj i analogjisë mund të aplikohet përjashtimisht gjatë interpretimit të dispozitave ligjore: **(1)** për bazat të cilat përjashtojnë ekzistimin e veprës penale, **(2)** për bazat të cilat përjashtojnë dënimin apo shërbejnë për matjen e dënimit, dhe **(3)** për bazat që kanë të bëjnë me të gjitha ato rrethana që krijojnë një situatë të favorshme për të pandehurin.

26. Bazuar në ato që u thanë më lart për analogjinë si llojin e të përfunduarit dhe llojin e interpretimit të së drejtës, u mor qëndrimi se që nga paraqitja e saj, analogjia në të drejtën lidhet me zbrazëtirat juridike dhe shërben si një mjet për plotësimin e tyre. Gjatë diskutimit për vendin e analogjisë në teorinë e së drejtës, argumentet e paraqitura janë të frymëzuara nga ideja se analogjia është një procedurë e cila gjendet në qendër ndërmjet interpretimit të së drejtës në kuptimin e rreptë, të ngushtë të fjalës dhe vetë krijimit të së drejtës. Fusha e vlefshmërisë së analogjisë në të drejtën penale materiale është e kufizuar me *"parimin e legalitetit nullum crimen, nulla poena sine lege"*.

27. Doktrina bashkëkohore penalo-juridike mbanë qëndrimin se analogjia juridike është gjithherë e ndaluar, pasi që është drejtpërdrejt e kundërt me parimin e legalitetit, ndërsa aplikimi i analogjisë ligjore nuk përjashtohet jashtë zonës së ndaluar, të determinuar me këtë parim.

(i) Parimet e përgjithshme përkitazi me nenin 7 të përcaktuara me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së

28. Garancia e mishëruar në nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 7 të KEDNJ-së, e cila është një element thelbësor i sundimit të ligjit, zë një vend të theksuar në sistemin mbrojtës të Konventës, siç nënvizohet nga fakti se neni 15 i KEDNJ-së nuk lejon asnjë shmangie nga ai në rast lufte ose rreziku tjetër publik. Siç rrjedh nga objekti dhe qëllimi i tij, ai duhet të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë të tillë që të sigurojë garanci efektive mbrojtëse kundër ndjekjes, dënimit dhe ndëshkimit arbitrar (shih Aktgjykimin *Korbely kundër Hungarisë [DHM]*, kërkesa nr. 9174/02, të 19 shtatorit 2008, paragrafi 69).

29. Prandaj, neni 33 i Kushtetutës dhe neni 7 i KEDNJ-së *"nuk kufizohen në ndalimin e zbatimit retroaktiv të ligjit penal në dëm të të akuzuarit: ai, gjithashtu mishëron, më përgjithësisht, parimin se vetëm ligji mund të përkufizojë një vepër penale dhe mund të parasheh një dënim (nullum crimen, nulla poena sine lege) dhe parimin që ligji penal nuk duhet të interpretohet gjerësisht në dëm të*

të akuzuarit, për shembull me anë të analogjisë. Nga këto parime rrjedh se një vepër penale duhet të përkufizohet qartë në ligj. Ky kusht plotësohet kur individi mund të ketë dijeni nga formulimi i dispozitës përkatëse - dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimit të tij nga gjykatat dhe me këshillën juridike të informuar - për të cilat veprime dhe mosveprime do të jetë penalisht përgjegjës" (shih Aktgjykimin *Korbely kundër Hungarisë,* të cituar më lartë, paragrafi 70).

30. Kur i referohen „ligjit", neni 7 i KEDNJ-së dhe neni 33 i Kushtetutës aludojnë për të njëjtin koncept si ai të cilit i referohet KEDNJ kudo tjetër kur e përdor këtë term, një koncept i cili përfshin të drejtën ligjore dhe gjyqësore dhe nënkupton kërkesa të cilësisë, kryesisht ato të qasshmërisë dhe parashikueshmërisë (shih rastin *EK kundër Turqisë,* kërkesa nr. 28496/95, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 51). Këto kërkesa të cilësisë duhet të përmbushen si në aspektin e përkufizimit të veprës penale, ashtu edhe në aspektin e dënimit të parashikuar për atë vepër (shih Aktgjykimin *Del Rio Prada kundër Spanjës,* kërkesa nr. 42750/09, të 21 tetorit 2013, paragrafi 91).

31. Sado qartë që të jenë hartuar dispozitat ligjore, në cilindo sistem ligjor, duke përfshirë edhe të drejtën penale, ekziston një element i pashmangshëm i interpretimit gjyqësor. Gjithmonë do të ekzistojë nevoja për sqarimin e pikave të dyshimta dhe për përshtatje me rrethanat që ndryshojnë. Në të vërtetë, zhvillimi progresiv i të drejtës penale përmes ligjbërjes gjyqësore është një pjesë e rrënjosur mirë dhe e domosdoshme e traditës juridike në shtetet në të cilat respektohet Konventa. Neni 7 i KEDNJ-së nuk mund të interpretohet sikur e ndalon sqarimin gradual të rregullave të përgjegjësisë penale përmes interpretimit gjyqësor rast pas rasti, me kusht që rezultati të jetë koherent me thelbin e veprës penale dhe i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Jorgić kundër Gjermanisë,* kërkesa nr. 74613/01, të 12 tetorit 2007, paragrafët 100-101).

32. Megjithatë, mungesa e një interpretimi gjyqësor të qasshëm dhe të parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme mund të çojë edhe në përfundimin për shkeljen e të drejtave të të akuzuarit nga neni 7 (shih, në lidhje me elementet përbërëse të veprës penale, rastin *Pessino kundër Francës,* kërkesa nr. 40403/02, Aktgjykim i 12 shkurtit 2007, paragrafët 35-36; në lidhje me dënimin, shih Aktgjykimin *Alimuçaj kundër Shqipërisë,* kërkesa nr. 20134/05, të 7 shkurtit 2012, paragrafët 154-162). Për të shmangur këtë, objekti dhe qëllimi i kësaj dispozite është pikërisht që askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndjekjes, dënimit apo ndëshkimit arbitrar (shih Aktgjykimin *Del Rio Prada kundër Spanjës,* të cituar më lart, paragrafi 93).

33. Përveç kësaj, rikujtojmë se, në parim, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta duhet t'i zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit. Kjo gjithashtu vlen edhe atëherë kur e drejta e brendshme i referohet rregullave të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare ose marrëveshjeve ndërkombëtare. Roli i Gjykatës kufizohet në konstatimin nëse efektet e një interpretimi të tillë janë të pajtueshme me Konventën dhe Kushtetutën (shih Aktgjykimin *Waite dhe Kennedi kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 26083/94, të 18 shkurtit 1999, paragrafi 54, shih, gjithashtu, Aktgjykimin *Korbely kundër Hungarisë*, të cituar më lart, paragrafi 72).

(ii) Zbatimi i parimeve të lartcekura në rastin e parashtruesit të kërkesës

34. Në dritën e parimeve të lartcekura në lidhje me shtrirjen e mbikëqyrjes së saj, rikujtojmë se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të vendosë mbi përgjegjësinë individuale penale të parashtruesit të kërkesës, që është kryesisht çështje e vlerësimit të gjykatave të rregullta. Gjithashtu, nuk është detyrë e Gjykatës të vendosë nëse në veprimet e parashtruesit të kërkesës ekziston figura e një vepre tjetër penale (për shembull, të mashtrimit nga neni 261 i KPPK-së apo të falsifikimit të dokumenteve nga neni 332 i KPPK-së), kjo gjithashtu është çështje e vlerësimit të gjykatave të rregullta (shih Aktgjykimin *Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë,* kërkesat nr. 34044/96, 35532/97 dhe 44801/98, të 22 marsit 2001, paragrafi 51).

35. Funksioni i Gjykatës, nga këndvështrimi i nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 paragrafi 1 të KEDNJ-së, është që të shqyrtojë nëse vepra penale për të cilën është dënuar parashtruesi i kërkesës është vepër penale e përkufizuar me qasshmëri dhe parashikueshmëri të mjaftueshme dhe nëse gjykatat e rregullta, në kundërshtim me parimin e legalitetit, përmes aplikimit të analogjisë kanë interpretuar gjerësisht ligjin penal në dëm të të akuzuarit (shih Aktgjykimin *Kokkinakis kundër Greqisë*, kërkesa nr. 14307/88, të 25 majit 1993, paragrafi 52).

A) Qasshmëria

36. Sa i përket aplikimit të parimeve të vendosura nga GJEDNJ-ja, konsiderojmë se fillimisht duhet të konstatohet nëse ligji penal dhe Ligji për Prokurimin Publik ishin të qasshëm për parashtruesin e kërkesës duke qenë se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta *"[...] në mënyrë arbitrare [...]"* i kanë dhënë atij, si shtetasit

të huaj, *"Drejtor Ekzekutiv i një OJQ-je të huaj (të Republikës së Shqipërisë), statusin e personit zyrtarë."*

37. Në këtë kuptim, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, rikujtojmë fillimisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore PKR. nr. 432/15, të 18 dhjetorit 2017, në të cilin parashtruesi i kërkesës u cilësua me statusin e *"personit zyrtar"* dhe u shpall fajtor për veprën penale nga neni 341 [Mashtrimi në detyrë] paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të Kodit të Përkohshëm Penal [Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25], i cili përcakton:

> *1. Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër bën prezentimin e rremë të raportit të llogarive apo i cili në mënyrë tjetër e vë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës së kundërligjshme dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.*
>
> *[...]*
>
> *3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon 5.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.*

38. Në vazhdim, Gjykata Themelore si provë kryesore materiale merr për bazë *"Deklaratën nën Betim"*, të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës, si përfaqësues i kompanisë, i cili në momentin e dorëzimit të tenderit deklaroi se *"operatori ekonomik [kompania e përfaqësuar nga parashtruesi i kërkesës] përmbush kërkesat e përshtatshmërisë të Ligjit Mbi Prokurim Publik në Kosovë, Ligji Nr. 2003/17, neni 61 [...] unë pranoj mendësinë e sanksioneve penale dhe civile, gjobave dhe dëmeve nëse operatori ekonomik në fjalë me qëllim apo për shkak të pakujdesisë dorëzon çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese."*

39. Bazuar në ato që u thanë më lart, konkludojmë se parashtruesi i kërkesës, si përfaqësues i operatorit ekonomik nga Republika e Shqipërisë, i cili operoi në territorin e Republikës së Kosovës dhe mori pjesë në tenderët publik të shpallur sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji nr. 2003/17, do të duhej të kishte dijeni për legjislacionin pozitivo-juridik të Republikës së Kosovës.

40. Duke nënshkruar *"Deklaratën Nën Betim"*, parashtruesi i kërkesës e pranoi si të vlefshëm legjislacionin pozitivo-juridik të Republikës së

Kosovës pavarësisht se ai është shtetas i huaj, përkatësisht shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe pavarësisht nga fakti se OJQ, drejtor ekzekutiv i së cilës është parashtruesi i kërkesës, është e regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

41. Gjithashtu, legjislacioni pozitivo-juridik i Republikës së Kosovës, dhe rrjedhimisht edhe Kodi i Përkohshëm Penal [Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25] sipas të cilit parashtruesi u shpall fajtor, si dhe Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji nr. 2003/17, sipas të cilit parashtruesi i kërkesës ka marrë pjesë në tenderin publik, janë dokumente të qasshme në faqet e internetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës si dhe në një mori faqesh tjera të internetit të institucioneve publike të Kosovës, të cilat kanë qenë mjaftueshëm të qasshme për parashtruesin e kërkesës, si përfaqësuesin e operatorit ekonomik.

42. Bazuar në ato që u thanë më lart, konkludojmë se ligjet të cilave i janë referuar Gjykata Themelore në Aktgjykimin PKR. nr. 432/15, të 18 dhjetorit 2017, Gjykata e Apelit në Aktgjykimin PAKR. nr. 528/2018, të 16 prillit 2019, si dhe Gjykata Supreme në Aktgjykimin Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, përkatësisht Kodi i Përkohshëm Penal [Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25] dhe Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji nr. 2003/17, ishin në fuqi dhe rrjedhimisht të vlefshme dhe qasshme në masë të mjaftueshme për parashtruesin e kërkesës.

B) Parashikueshmëria

43. Në vazhdim të testit lidhur me nenin 7 të KEDNJ-së, duhet të shqyrtojmë nëse Kodi i Përkohshëm Penal [Rregulloja e UNMIK-ut 2003/25] dhe Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji nr. 2003/17, ishin të parashikueshëm dhe nëse u interpretuan nga gjykatat e rregullta, përmes aplikimit të analogjisë, në mënyrë të gjerë dhe të paparashikueshme në dëm të parashtruesit të kërkesës.

44. Rikujtojmë se parashtruesi i kërkesës, duke nënshkruar *"Deklaratën nën betim",* pranoi legjislacionin pozitivo-juridik në fuqi të Republikës së Kosovës pavarësisht nga fakti se ai është shtetas i huaj, përkatësisht shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe pa marrë parasysh se OJQ, drejtor ekzekutiv i së cilës është parashtruesi i kërkesës, është e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, por pyetja që shtrohet tani para nesh është **i)** nëse parashtruesi i kërkesës me nënshkrimin e *"Deklaratës nën Betim"* fitoi cilësinë e *"personit zyrtar"* dhe **ii)** nëse parashtruesi i kërkesës mund të ketë parashikuar se kishte fituar cilësinë e *"personit zyrtar"*.

45. Vërejmë se në bazë të kësaj *"Deklarate nën Betim"* e cila është pjesë e dokumentacionit tenderues, Gjykata Themelore kishte vërtetuar se është *"... fakt që i akuzuari Albert Rakipi përfaqësoi Institutin si person zyrtar, sepse veproi si një organizatë biznesi - person juridik, pasi që sipas Ligjit për Prokurimin Publik, përkatësisht sipas dispozitës nga neni 61 i ligjit në fjalë, ai ka kryer detyrime të veçanta në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik."*

46. Vërejmë se është evidente se Gjykata Themelore konkludoi se parashtruesi i kërkesës e ka statusin e personit zyrtar duke aplikuar analogjinë nga Ligji për Prokurimin Publik, përkatësisht sipas dispozitës nga neni 61 i Ligjit në fjalë, ku vetë *"Deklarata nën Betim"* nuk është pjesë e Ligjit për Prokurimin Publik, por edhe ajo është nxjerrë nga norma ligjore e nenit 61 të Ligjit për Prokurimin Publik. Prandaj, Gjykata vëren se Gjykata Themelore nuk e arsyetoi statusin e *"personit zyrtar"* në pajtim me nenin 107 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, që ka qenë obligim i Gjykatës Themelore.

47. Më tej, rikujtojmë se parashtruesi i kërkesës e kishte ngritur pretendimin e tij se ai nuk e kishte statusin e *"personit zyrtar"* edhe para gjykatave të rregullta, përkatësisht në ankesat e tij të drejtuara Gjykatës së Apelit dhe në kërkesat e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Prandaj, në këtë rast, do t'iu referohemi edhe arsyetimeve të Gjykatës së Apelit dhe arsyetimeve të Gjykatës Supreme në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës.

48. Së pari, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit PAKR nr. 27/2018, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se ai nuk e ka statusin e *personit zyrtar*, vlerësoi se Gjykata Themelore në lidhje me këtë pretendim kishte dhënë arsye të nevojshme, të cilat arsye *"[...] i aprovon edhe kjo Gjykatë dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësime."*

49. Ne vërejmë se në rastin konkret Gjykata e Apelit vazhdoi me zbatimin e analogjisë në përcaktimin e statusit të *"personit zyrtar"* të vetë parashtruesit të kërkesës duke pranuar interpretimin e mëparshëm analog të Gjykatës Themelore.

50. Gjatë rigjykimit në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit në Aktgjykimin e saj PAKR nr. 528/2019, të 16 prillit 2019, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se ai nuk e ka statusin e *"personit zyrtar"*, vlerësoi se:

"[...] qëndron fakti se [parashtruesi i kërkesës] është shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe se Instituti për Studime Ndërkombëtare të cilën e përfaqëson i akuzuari është i themeluar ne Shqipëri, por nga ky fakt nuk mund te konkludohet se ky i akuzuar në rastin konkret nuk e ka cilësinë e personit zyrtar. Sepse, sipas Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës nr. 2003/17 ky Institut si palë e interesuar ka ofertuar në Kosovë si operator ekonomik (ka ofruar shërbime respektivisht ka kontraktuar punë) dhe [parashtruesi i kërkesës] përveç që e përfaqëson Institutin si person zyrtar me rastin e fitimit te tenderit nga autoriteti kontraktues (Universiteti i Prishtinës) ka marrë përsipër ushtrimin e detyrave të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj."

51. Këtu vërejmë se Gjykata e Apelit vazhdoi me një interpretim të gjerë dhe analog të termit *"person zyrtar"* përmes Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 2003/17, pa arsyetuar me asnjë fjalë të vetme në bazë të cilit paragraf të nenit 107 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, parashtruesi i kërkesës, si shtetas i huaj, ose person juridik i huaj, e ka statusin e *"personit zyrtar"* dhe pa arsyetuar se ***"cilin funksion publik ose cilin autoritet publik kishte ushtruar parashtruesi i kërkesës në mënyrë që të konsiderohet person zyrtar"***. Përkundër kësaj, Gjykata e Apelit arsyeton përmes negacionit se *"... nuk mund të konkludohet se ky i akuzuari në rastin konkret* ***nuk e ka cilësinë e personit zyrtar****",* që është qartazi një interpretim i gjerë i termit *"person zyrtar"* duke aplikuar analogjinë negative. Gjykata e Apelit ishte e detyruar të provojë dhe arsyetojë **"pse i pandehuri e ka statusin e personit zyrtar"**.

52. Gjithashtu i referohemi edhe pretendimit specifik të parashtruesit të kërkesës të ngritur në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, me të cilin theksoi:

"Parashtruesi është dënuar për veprën penale nga neni 341 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës "mashtrim në detyrë". Mashtrimi në Detyrë mund të kryhet vetëm nga "personi zyrtar". Duke e marre parasysh faktin se OJQ "ISN" (Republika e Shqipërisë) ka qene në marrëdhënie kontraktuale me Universitetin e Prishtinës, pyetjet e radhës të cilat duhet të adresohen janë:

a. Nëse secilit operatore ekonomik duhet t'i ipet statusi i "personit zyrtar" sipas kodit të përkohshëm penal, si dhe:

b. A ka mundësi qe të këtë statusin e personit zyrtar personi përgjegjës i një OJQ-je të huaj e cila nuk është e regjistruar në Republikën e Kosovës."

53. Në vijim, rikujtojmë arsyetimin e dhënë nga Gjykata Supreme, e cila në Aktgjykimin e saj të kontestuar Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, theksoi se: *"[...] vepra penale në fjalë mund ta kryhet ekskluzivisht nga personi zyrtar dhe me këtë rast gjykatat e instancave më të ulëta e kanë potencuar në vendimet e tyre faktin se [parashtruesi i kërkesës] kishte këtë cilësi, dhe për më tepër, kanë cituar dispozitat ligjore që përcaktojnë cilësinë e personit zyrtar edhe pse bëhet fjale për shtetas te Republikës se Shqipërisë dhe organizata "ISD" po ashtu kishte selinë në Tiranë, megjithatë nuk kishte dyshime se i dënuari kishte cilësinë e personit zyrtar pasi që përveç faktit se ishte përfaqësues i "ISD-së" dhe kishte ofertuar ne Kosove si përfaqësues i operatorit ekonomik, kishte marre për sipër ushtrimin e posaçëm të detyrave zyrtare në baze të autorizimit ligjor siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 107 te KPPK-së [Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës]".*

54. Këtu vërejmë se përkundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës gjatë gjithë procedurës se ai nuk e ka statusin e *"personit zyrtar"*, shpjegimi i vetëm në lidhje me statusin e tij është dhënë nga Gjykata Supreme me fjalinë *"siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 107 të KPPK-së [Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës]"*, duke i pranuar interpretimet e mëparshme të Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore, pa arsyetuar se për cilin paragraf të nenit 107 të KPPK-së bëhet fjalë dhe çfarë autorizimi zyrtar dhe çfarë autoriteti publik kishte ushtruar parashtruesi i kërkesës, edhe pse vetë ligji e bëri në mënyrë të qartë dallimin midis shtetasve të Kosovës dhe shtetasve të huaj dhe statusit të personit zyrtar në nenin 107 të KPPK-së.

55. Në mbështetje të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se gjykatat e rregullta duke aplikuar analogjinë i dhanë parashtruesit të kërkesës statusin e personit zyrtar, i referohemi edhe përfundimit të Gjykatës Supreme në lidhje me të akuzuarin tjetër H.V., ku "*Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj drejtë ka konstatuar se në veprimet e të dënuarit H.V. janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale mashtrimi në detyrë nga neni 341 par. 3 lidhur me par. 1 dhe nenit 23 të KPPK-së,* ***pasi që i dënuari H.V. kishte cilësinë e personit zyrtar siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 107 par. 1 nënpar. 1.1 të KPPK-së, meqë ishte i zgjedhur për të përfaqësuar UP përkatësisht zyrën e prokurimit****."*

56. Në këtë kontekst, vërejmë se një arsyetim kaq i qartë në lidhje me statusin e *"personit zyrtar"* nuk iu dha parashtruesit të kërkesës në asnjë prej aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, përkundrazi, statusi i tij çdoherë është konstatuar me përdorimin e analogjisë bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik nr. 2003/17, duke mos arsyetuar me asnjë fjalë të vetme se në bazë të cilit paragraf të nenit 107 të Kodit të Përkohshëm Penal parashtruesi i kërkesës e ka cilësinë e personit zyrtar.

57. Në vijim rikujtojmë se gjykatat e rregullta me rastin e cilësimit të parashtruesit të kërkesës si person zyrtar iu referuan edhe dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik, duke arsyetuar se ai e nënshkroi "Deklaratën nën Betim" në pajtim me procedurat e përcaktuara me këtë Ligj, dhe kishte ofertuar dhe ishte zgjedhur si operator ekonomik për kryerjen e shërbimeve për një institucion publik, përkatësisht për Universitetin e Prishtinës.

58. Ritheksojmë se parashtruesi i kërkesës, si para gjykatave të shkallës më të ulët, ashtu edhe para Gjykatës Supreme, kishte ngritur çështjen e interpretimit dhe aplikimit në bazë të analogjisë të Ligjit për Prokurimin Publik. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar më 12 qershor 2019, po ashtu në mënyrë specifike pretendoi se "*Zbatimi i Ligjit për Prokurim Publik për të dhënë statusin e personit zyrtarë [të parashtruesit të kërkesës] është arbitrarë, sepse ky ligj nuk merret fare me përcaktimin e statusit të personave zyrtarë, por përcakton procedurat e prokurimit në tenderët publikë. Edhe sikur Ligji i Prokurimit të përcaktonte domethënien e shprehjes "person zyrtarë" në të drejtën penale është e ndaluar analogjia andaj edhe dispozitat e këtij ligji nuk do të gjenin zbatim, sepse statusin e personit zyrtarë mund ta kenë vetëm personat e përcaktuar në mënyrë taksative në Kodin Penal. Ndalimi i aplikimit te analogjisë në të drejtën penale është në funksion të sigurisë juridike të subjekteve të së drejtës. Vërehet qartë se në këtë çështje penale Gjykata e Apelit e ka shkelur këtë parim. Ndalesa e analogjisë taksativisht është parashikuar me nenin 1 par 3 te Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës sipas të cilit: "Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi në bazë të analogjisë".*"

59. Duke u kthyer te pretendimet konkrete të parashtruesit të kërkesës për interpretimin e Ligjit për Prokurimin Publik në bazë të analogjisë, rikujtojmë se ky parim është mishëruar edhe në dispozitat kushtetuese, përkatësisht në nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës dhe nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së, dhe përcakton se *"vetëm ligji mund t'i*

përcaktojë krimet dhe të parashikojë masat e dënimit (nullum crimen, nulla poena sine lege) si edhe atë që urdhëron që ligji penal të mos zbatohet në mënyrë të zgjeruar në dëm të të akuzuarit, sidomos për analogji; nga kjo rezulton se një vepër penale duhet të përcaktohet qartë në ligj. Ky kriter konsiderohet i plotësuar kur personi mund të ketë dijeni nga formulimi i dispozitës përkatëse, dhe nëse është nevoja, me ndihmën e interpretimit të tij nga gjykatat, për të cilat veprime dhe mosveprime do të jetë përgjegjës" (shih rastin e GJEDNJ-së, *Kokkinakis kundër Greqisë,* kërkesa nr. 14307/88, Aktgjykim i 25 majit 1993, paragrafi 52). Përveç kësaj, ky parim po ashtu është i mishëruar edhe në paragrafin 3 të nenit 1 [Parimi i Ligjshmërisë] të KPPK-së, përmes të cilit përcaktohet që: " [...] *3. Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit i cili hetohet, ndiqet ose shpallet fajtor."*

60. Konsiderojmë se janë të bazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Ligji për Prokurimin Publik nuk ofron përkufizimin e *"personit zyrtar"*, megjithatë, vërejmë se gjykatat e rregullta në vendimet e tyre i janë referuar këtij ligji për të arsyetuar se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e përfaqësuesit të kompanisë, kishte ofruar shërbime si operator ekonomik për nevoja të një autoriteti publik.

61. Në bazë të arsyetimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, vërejmë se kjo gjykatë, përmes aplikimit të analogjisë, në mënyrë të gjerë dhe të paparashikueshme, interpretoi ligjin në dëm të parashtruesit të kërkesës kur vërtetoi se parashtruesi i kërkesës është person zyrtar në pajtim me nenin 107 të KPPK-së, pa arsyetuar apo elaboruar me asnjë fjalë të vetme vetë nenin 107 të KPPK-së. Kjo sepse Gjykata Supreme vërtetoi gjetjen ose vlerësimin e gjykatave më të ulëta, të cilat, sipas analogjisë, i zbatuan edhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

62. Rrjedhimisht, vlerësojmë se parashtruesi i kërkesës, duke nënshkruar *"Deklaratën nën Betim"* në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik nuk mund të kishte parashikuar në masë të mjaftueshme se ai e ka fituar statusin e *"personit zyrtar"*. Duke nënshkruar *"Deklaratën nën Betim"* në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik, parashtruesi i kërkesës mund të kishte parashikuar se ai është penalisht përgjegjës sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, por jo se ai e ka fituar statusin e *"personit zyrtar"* dhe se kështu mund të përgjigjet edhe për veprat penale të kualifikuara.

63. Prandaj, konsiderojmë se gjykatat e rregullta, gjatë gjithë procedurës, përmes aplikimit të analogjisë, interpretuan ligjin në mënyrë të gjerë dhe të paparashikueshme në dëm të parashtruesit të kërkesës, duke interpretuar se me nënshkrimin e *"Deklaratës nën Betim"*, parashtruesi i kërkesës kishte fituar statusin e *„personit zyrtar"* në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik, por ky Ligj nuk përcakton apo nuk parashikon përkufizimin e personit zyrtar, ku një interpretim i tillë i paparashikueshëm për parashtruesin ndikoi drejtpërdrejtë edhe në cilësimin e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

64. Për më tepër, ritheksojmë se Gjykata Supreme vërtetoi qëndrimin e gjykatave të rregullta, pa u përgjigjur në pretendimin specifik të parashtruesit të kërkesës në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Ligjit për Prokurimin Publik, në të cilin rast, si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës ishte cilësuar si person zyrtar.

65. Në këtë rast konkret, konsiderojmë se gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme, nuk arsyetuan ose nuk shpjeguan në mënyrë specifike për çfarë arsye veprat penale "Mashtrimi" ose "Falsifikimi i dokumenteve zyrtare" nuk kanë mundur të aplikohen në rastin e tij.

66. Rrjedhimisht, konsiderojmë se aktgjykimet e kontestuara, respektivisht: Aktgjykimi [Pml. nr. 253/2019] i Gjykatës Supreme, i 30 shtatorit 2019, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 528/2018, të 16 prillit 2019 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore PKR. nr. 432/15, të 18 dhjetorit 2017, nuk i kanë plotësuar kriteret e "parimit të legalitetit" sipas nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së, për shkak se gjykatat e rregullta, gjatë gjithë procedurës gjyqësore, përmes aplikimit të analogjisë, interpretuan dispozitat ligjore në fuqi në mënyrë të gjerë dhe të paparashikueshme në dëm të parashtruesit të kërkesës (shih Aktgjykimin *Kokkinakis kundër Greqisë,* kërkesa nr. 14307/88, të 25 majit 1993, paragrafi 52).

67. Në fund, ritheksojmë se ky përfundim ka të bëjë ekskluzivisht me aktgjykimet e kontestuara nga pikëpamja e interpretimit të ligjit në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit të tij në rigjykim. Gjithashtu, ritheksojmë se Gjykata nuk është e thirrur të vendosë për përgjegjësinë individuale penale të parashtruesit të kërkesës, që në rend të parë është çështje e vlerësimit të gjykatave të rregullta. Tutje, Gjykata rithekson se nuk është e thirrur për të vendosur nëse në veprimet e parashtruesit të kërkesës ekziston figura e një vepre tjetër penale, kjo gjithashtu është çështje e vlerësimit të gjykatave të rregullta në rigjykim (shih Aktgjykimin *Streletz, Kessler dhe Krenz*

kundër Gjermanisë, kërkesat nr. 34044/96, 35532/97 dhe 44801/98, të 22 marsit 2001, paragrafi 51).

Përfundim

68. Bazuar në sa më sipër dhe duke marrë parasysh shqyrtimet e pretendimeve të parashtruesit në kërkesën e tij:

I. Pajtohemi se janë të bazuara pretendimet e parashtruesit se atij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së;

II. Gjithashtu, konsiderojmë se janë të bazuara pretendimet e parashtruesit se gjykatat e rregullta gjatë gjithë procedurës gjyqësore, përmes aplikimit të analogjisë, në mënyrë të gjerë dhe të paparashikueshme, interpretuan dispozitat ligjore në dëm të parashtruesit të kërkesës dhe se për pasojë është shkelur neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] i Kushtetutës në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së. Gjithashtu, konsiderojmë se aktgjykimet e kontestuara, respektivisht: Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 528/2018, të 16 prillit 2019 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore PKR. nr. 432/15, të 18 dhjetorit 2017, nuk i kanë plotësuar kriteret e "parimit të legalitetit" sipas nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së, për shkak se gjykatat e rregullta, gjatë gjithë procedurës gjyqësore, përmes aplikimit të analogjisë, interpretuan dispozitat ligjore në fuqi në mënyrë të gjerë dhe të paparashikueshme në dëm të parashtruesit të kërkesës.

III. Në fund, konsiderojmë se do të duhej të ishin shpallur të pavlefshëm: Aktgjykimi Pml. nr. 253/2019 i Gjykatës Supreme të Kosovës, i 30 shtatorit 2019, Aktgjykimi PAKR. nr. 528/2018 i Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, i 16 prillit 2019, dhe Aktgjykimi PKR. nr. 432/15 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, i 18 dhjetorit 2017.

Mendimi konkurrues u paraqit nga gjyqtarët:

Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar

_____

Safet Hoxha, gjyqtar

_____

Radomir Laban, gjyqtar

_____

KI160/19, KI161/19,KI162/19, KI164/19, KI165/19,KI166/19, KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19, KI171/19, KI172/19, KI173/19 dhe KI178/19, Parashtrues të kërkesës: Muhamet Këndusi dhe të tjerët Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019

KI160/19, KI161/19,KI162/19, KI164/19, KI165/19, KI166/19,KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19,KI171/19, KI172/19, KI173/19 dhe KI178/19, Aktgjykim i miratuar më 27 janar 2021, publikuar më 15 shkurt 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për t'u dëgjuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm*

Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesit e kërkesës u ankuan në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër vendimit të AKP-së përkatësisht për shkak të mos përfshirjes së tyre në listën përfundimtare të punëtorëve të NSH "Agimi" Gjakovë. Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme vendosi që parashtruesit e kërkesës të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e 20% nga privatizimi i NSH "Agimi" Gjakovë. Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme, pas ankesës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pa mbajtur seancë dëgjimore, ndryshoi vendimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme dhe refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit e kërkesës të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e 20% nga privatizimi i NSH "Agimi" Gjakovë. Parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar, mes tjerash, shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), për shkak të mos mbajtjes së seancës dëgjimore.

Gjykata vlerësoi pretendimet e parashtruesve te kërkesës, përkitazi me mungesën e seancës dëgjimore në rrethanat e rastit të tyre, si një ndër garancitë e përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenit 6 të KEDNJ-së, duke mbështetur këtë vlerësim në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë:GJEDNJ).

Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht ka shtjelluar parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika e saj gjyqësore dhe ajo e GJEDNJ-së, përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore, duke i sqaruar rrethanat në të cilat një e tillë është e domosdoshme, bazuar mes tjerash, në Aktgjykimin e Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë. Gjykata ka sqaruar, mes tjerash, se (i) mungesa e kërkesës së një pale për

seancë dëgjimore jo detyrimisht nënkupton heqjen dorë nga një e drejtë të tillë dhe nëse mungesa e një kërkese të tillë nënkupton heqjen dorë të një pale nga kjo e drejtë, varet nga specifikat e ligjit dhe rrethanat e veçanta të një rasti; dhe (ii) në parim, palët kanë të drejtë në një seancë dëgjimore në të paktën një nivel të juridiksionit, përpos nëse "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore", e të cilat bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim ndërlidhen me raste në të cilat shqyrtohen "çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike".

Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tyre nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtojë me nismën e tij domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore; (ii) parashtruesve të kërkesës iu është mohuar e drejta e seancës dëgjimore në të dy nivelet e DHPGJS-së; (iii) Kolegji i Apelit, nuk kishte trajtuar "çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike" dhe rrjedhimisht nuk "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore"; (iv) Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar çështje "fakti dhe ligji" për më tepër që, kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar në dëm të parashtruesve të kërkesës; dhe (v) Kolegji i Apelit, nuk kishte arsyetuar "heqjen dorë nga seanca gojore". Duke marrë parasysh këto rrethana dhe arsyetimet e tjera të dhëna në këtë Aktgjykim, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore.

Gjykata gjithashtu theksoi se (i) bazuar në ligjin e aplikueshëm për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për vlerësimin e vendimeve të Kolegjit të Specializuar dhe rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka mundësinë e korrigjimit të mungesës së seancës dëgjimore në nivelin e gjykatës më të ulët, përkatësisht, Kolegjit të Specializuar; dhe (ii) nuk është e nevojshme të trajtohen pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës sepse të njëjtat duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit në përputhshmëri me konstatimet e këtij Aktgjykimi; dhe (iii) konstatimi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret ndërlidhet vetëm me garancitë procedurale për një seancë dëgjimore dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet, si dhe nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

Gjykata po ashtu konstatoi se kërkesa nr. KI178/19 e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës Jakup Abaz Agaj duhet të refuzohet e papranueshme

qartazi e pabazuar siç specifikohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, për shkak se nuk ka ofruar ndonjë provë që do ta lironte atë nga obligimi për mos respektim të afatit ligjor për paraqitje të ankesës në DHPGJS.

AKTGJYKIM

në

rastet nr. KI160/19, KI161/19,KI162/19, KI164/19, KI165/19, KI166/19,KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19,KI171/19, KI172/19, KI173/19 dhe KI178/19

Parashtrues

Muhamet Këndusi dhe të tjerët

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Muhamet Këndusi (KI160/19), Fatime Llukaci (KI161/19), Gani Llukaci (KI162/19), Xhavit Meka (KI164/19), Vitore Hila-Frrokaj (KI165/19), Nerxhivane Peni (KI166/19), Bahri Qorri (KI167/19), Sabire Rudi (KI168/19), Genc Roka (KI169/19), Alush Gojani (KI170/19), Elvane Sylafeta (KI171/19), Fahredin Zeka (KI172/19), Fllanza Dylatahu-Gjoka (KI173/19) dhe Jakup Abaz Agaj (KI178/19) (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), nga Gjakova, Mitrovica dhe Deçani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesve të kërkesave u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të drejtë dhe të Paanshëm], dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: kushtetuta), nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesit e kërkesës, përmes postës, dorëzuan kërkesat në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) si në vijim:
(i) parashtruesi i kërkesës Muhamet Këndusi (KI160/19) më 23 shtator 2019,

(ii) parashtruesi i kërkesës Fatime Llukaci (KI161/19) më 23 shtator 2019,

(iii) parashtruesi i kërkesës Gani Llukaci (KI162/19) më 23 shtator 2019,

(iv) parashtruesi i kërkesës Xhavit Meka (KI164/19) më 25 shtator 2019,

(v) parashtruesi i kërkesës Vitore Hila-Frrokaj (KI165/19) më 25 shtator 2019,

(vi) parashtruesi i kërkesës Nerxhivane Peni (KI166/19) më 25 shtator 2019,

(vii) parashtruesi i kërkesës Bahri Qorri (KI167/19) më 24 shtator 2019,

(viii) parashtruesi i kërkesës Sabire Rudi (KI168/19) më 25 shtator 2019,

(ix) parashtruesi i kërkesës Genc Roka (KI169/19) më 25 shtator 2019,

(x) parashtruesi i kërkesës Alush Gojani (KI170/19) më 25 shtator 2019,

(xi) parashtruesi i kërkesës Elvane Sylafeta (KI171/19) më 25 shtator 2019,

(xii) parashtruesi i kërkesës Fahredin Zeka (KI172/19) më 26 shtator 2019,

(xiii) parashtruesi i kërkesës Fllanza Dylatahu-Gjoka (KI173/19) më 26 shtator 2019,

(xiv) parashtruesi i kërkesës Jakup Abaz Agaj (KI178/19) më 1 tetor 2019.

6. Më 4 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.

7. Më 4 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave nr. KI160/19,KI161/19,KI162/19,KI164/19,KI165/19,KI166/19,KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19, KI171/19, KI172/19, KI173/19 dhe KI178/19.

8. Më 10 tetor 2019, parashtruesit u njoftuan për regjistrim dhe bashkim të kërkesave dhe një kopje e kërkesave iu dërgua Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme.

9. Më 27 janar 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

10. Në të njëjtën ditë, Gjykata me shumicë konstatoi se (i) kërkesat nr. KI160/19, KI161/19, KI162/19, KI164/19, KI165/19, KI166/19, KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19, KI171/19, KI172/19, KI173/19 janë të pranueshme; (ii) për kërkesat nr. KI160/19, KI161/19,KI162/19, KI164/19, KI165/19, KI166/19, KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19, KI171/19, KI172/19, KI173/19 ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe, (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.

11. Në të njëjtën ditë, Gjykata shpalli të papranueshme kërkesën nr. KI178/19 me parashtrues të kërkesës Jakup Abaz Agaj.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se Ndërmarrja Shoqërore NSH "Agimi" Gjakovë është privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) dhe kontrata e shitjes me ofertuesin ishte aprovuar më 15 shtator 2010. Në të njëjtën datë, përmes shkresës [nr.1065], parashtruesit e kërkesës ishin njoftuar se "*pasoja shitjes së aseteve kryesore është përfundimi i punësimit tuaj*" dhe se i njëjti "*përfundon menjëherë*". Të gjithë parashtruesit e kërkesës ishin punëtorë të ndërmarrjes përkatëse në intervale të caktuara kohore.

13. Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime ishte publikuar më 22 dhjetor 2011 dhe data e fundit për dorëzimin e ankesave në AKP kundër Listës Përfundimtare ishte 14 janar 2012.

14. Më 13 dhjetor 2011, AKP-ja refuzoi të pabazuara ankesat e parashtruesve lidhur me mos përfshirjen e emrave të tyre në listën e përkohshme të punëtorëve me të drejtën e përfitimit të një pjese prej 20 % të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Agimi" Gjakovë. Parashtruesit u udhëzuan për të drejtën e ankimit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme brenda njëzet (20) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të AKP-së. Parashtruesi i kërkesës KI178/19 (Jakup Abaz Agaj) nuk kishte qenë palë në këtë procedurë.

15. Parashtruesit e kërkesave përfshirë dhe parashtruesin e kërkesës nr. KI178/19 (Jakup Abaz Agaj) u ankuan në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër vendimit të AKP-së përkatësisht për shkak të mos përfshirjes së tyre në listën përfundimtare të punëtorëve të NSH "Agimi" Gjakovë. Në parim, të gjithë kishin pretenduar se nuk ishin trajtuar në mënyrë të barabartë me punëtorët e tjerë që ishin përfshirë ne Listën Përfundimtare dhe rrjedhimisht ishin diskriminuar.

16. Më 4 shtator 2013, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme me Aktgjykimin (SCEL-11-0075) për parashtruesit e kërkesave KI160/19, KI161/19, KI162/19, KI164/19, KI165/19, KI166/19, KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19, KI172/19, dhe KI173/19 vendosi që të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e 20% nga privatizimi i NSH "Agimi" Gjakovë. Për ankesën e parashtruesit të kërkesës nr. KI171/19 (Elvane Sylafeta) vendosi që ta refuzojë të pabazuar kurse ankesën e parashtruesit të kërkesës nr. KI178/19 (Jakup Abaz Agaj) vendosi që ta hedh poshtë të paafatshme.

17. Përkitazi me parashtruesve të kërkesave KI160/19, KI161/19, KI162/19, KI164/19, KI165/19, KI166/19, KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19, KI172/19, dhe KI173/19 Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme sqaroi: (i) se gjatë viteve të 90-ta atyre u ishte ndërprerë marrëdhënia e punës dhe janë larguar nga puna duke u zëvendësuar me punëtorë serb çka është "ngjarje e ditur botërisht" dhe se rrjedhimisht janë diskriminuar;(ii) parashtruesit e kërkesës do t'i kishin plotësuar kushtet në kuptim të nenit 10.4 të Rregullores 2003/13, po të mos ishin subjekt i diskriminimit, ngase të njëjtëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës gjatë viteve të 90-ta. Kolegji i Specializuar po ashtu vlerësoi se AKP-ja si palë e paditur ka obligim në kuptim të nenit 8 të ligjit mbi diskriminim 2004/3, që përcakton: *"[...] se kur personat të cilët konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre paraqesin fakte para Gjykatës nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë barra e provës bie mbi palën e paditur e cila duhet të dëshmoj se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, andaj pas gjithë këtyre Gjykata erdhi në përfundim se ankesat e ankuesve të cekur më lart janë të vlefshme dhe urdhërohen që emrat e tyre të futen në Listën Përfundimtare të punëtorëve."*

18. Ankesa e parashtruesit të kërkesës nr. KI171/19 (Elvane Sylafeta) ishte refuzuar e pabazuar sepse nuk kishte dorëzuar asnjë dëshmi për shqyrtim dhe administrim siç parashihet me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut

2004/45 që përcakton se punëtorët që konsiderohen legjitim për pjesëmarrje në 20% të fitimit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore duhet të dëshmojnë: (i) janë punëtorë të regjistruar të ndërmarrjes shoqërore përkatëse në kohën e privatizimit; dhe, (ii) se kanë qenë në listën e pagave të ndërmarrjes shoqërore për jo më pak se tri (3) vite.

19. Ankesa e parashtruesit të kërkesës nr. KI178/19 (Jakup Abaz Agaj) u hodh poshtë e paafatshme sepse në pajtim me nenin 10.6, pika (a) e Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 afati i fundit i paraqitjes së ankesës ka qenë 21 janar 2012, ndërsa ankesa ishte paraqitur më 30 prill 2012. Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme po ashtu shtoi se parashtruesi i kërkesës nr. KI178/19 nuk kishte bashkangjitur ndonjë provë që arsyeton mos respektimin e afatit ligjor për paraqitje të ankesës.

20. AKP-ja paraqiti ankesë kundër aktgjykimi të lartpërmendur në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme duke pretenduar se Aktgjykimi i ankimuar është jokonsistent i pa argumentuar në bazë të ligjit, nuk përmban fakte qenësore dhe në mënyrë arbitrare e interpreton ligjin. Sipas AKP-së asnjë ankues i cili me aktgjykimin e atakuar është përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për marrjen e një pjese të ardhurave nga privatizimi i NSH "Agimi" nuk ka prezantuar fakte relevante në bazë të cilave kishte për ta vërtetuar faktin e trajtimit të pabarabartë dhe arsyetimin për diskriminim direkt apo të tërthortë në pajtim me nenin 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit.

21. Ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme paraqitën parashtruesit e kërkesave KI171/19 (Elvane Sylafeta) dhe KI178/19 (Jakup Abaz Agaj). Parashtruesja e kërkesës KI171/19 (Elvane Sylafeta) duke pohuar se në bazë të dëshmive të dorëzuara ajo ka punuar në NSH "Agimi" jo më pak se 3 vjet pavarësisht se të ardhurat nuk janë paguar për shkak të vështirësive të asaj ndërmarrje, parashtruesja e kërkesës po ashtu kishte pohuar se ka shumë dëshmitarë që vërtetojnë faktin se ajo ka punuar në NSH "Agimi" që nga fillimi deri në fund. Parashtruesi i kërkesës KI178/19 (Jakup Abaz Agaj) kishte pohuar se nuk kishte pasur informacion më herët lidhur me listën përfundimtare dhe s listën e kishte pranuar vetëm 3 ditë para se të ankohej në gjykatë dhe se në bazë të dëshmive të dorëzuara ai ka punuar në NSH "Agimi" jo më pak se 3 vjet pavarësisht se të ardhurat nuk janë paguar për shkak të vështirësive të asaj ndërmarrje, parashtruesi i kërkesës po ashtu kishte pohuar se ka shumë dëshmitarë që vërtetojnë faktin se ai ka punuar nga fillimi në NSH "Agimi".

22. Më 29 gusht 2019, Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme me Aktgjykim AC-I-13-0181-A0008 e pranoi të bazuar ankesën e AKP-së lidhur me parashtruesit KI160/19; KI161/19; KI162/19; KI164/19; KI165/19; KI166/19; KI167/19; KI168/19;KI169/19; KI170/19; KI172/19; dhe KI173/19 dhe që të njëjtit të hiqen nga lista e përfituesve të 20% nga procesit i privatizimit të NSH "Agimi" Gjakovë. Ankesat e parashtruesve të kërkesave KI171/19 (Elvane Sylafeta) dhe KI178/19 (Jakup Abaz Agaj) u refuzuan të pabazuara. Për sa i përket pretendimeve për diskriminim në baza etnike, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme shtoi se nuk pajtohet me konstatimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme për diskriminim të parashtruesve të kërkesave, sepse në pajtim me praktikën e Dhomës së Posaçme, ata janë të "nacionalitetit shqiptar" dhe nuk kanë mundur të kenë qenë të diskriminuar, në baza etnike, pas periudhës së qershorit të vitit 1999. Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konkludoi se qasja e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme lidhur me çështjen e interpretimit të diskriminimit të parashtruesve të kërkesës nuk është e saktë dhe e bazuar në ligj, dhe si e tillë, është *"në kundërshtim me të drejtën precedentale"*.

23. Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme duke u bazuar në nenin 69.1 të Shtojcës së Ligjit nr.06/086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, vendosi "*që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës"* dhe vendosi si në vijim:

    (i) Për parashtruesin Bahri Qorri (KI167/19) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka ofruar dëshmi për diskriminim, se ai kishte arritur moshën e pensionimit para privatizimit të NSH "Agimi" dhe se nuk plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se rrjedhimisht nuk i njihet e drejta për përfshirje në listën përfundimtare për përfitimin e 20% nga shtija e NSH "Agimi".

    (ii) Për parashtruesen Fatime Llukaci, (KI161/19) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se ajo nuk është diskriminuar, se nuk ka ofruar "asnjë provë" për ta provuar faktin se ka punuar në NSH "Agimi" para ose pas qershorit 1999 apo se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

    (iii) Për parashtruesin Gani Llukaci (KI162/19) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka ofruar dëshmi për diskriminim, se ai kishte arritur moshën e pensionimit para

privatizimit të NSH "Agimi" dhe se nuk plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se rrjedhimisht nuk i njihet e drejta për përfshirje në listën përfundimtare për përfitimin e 20% nga shtija e NSH "Agimi".

(iv) Për parashtruesen Vitore Hilaj Frrokaj (KI165/19) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka qenë e diskriminuar, nuk ka ofruar "asnjë provë" për ta provuar faktin se ka themeluar marrëdhënie pune në NSH "Agimi" apo se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se rrjedhimisht nuk i njihet e drejta për përfshirje në listën përfundimtare për përfitimin e 20% nga shtija e NSH "Agimi".

(v) Për parashtruesen Fllanza Dylatahu Gjoka, (KI173/19) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka qenë e diskriminuar, nuk ka ofruar "asnjë provë" për ta provuar faktin se ka themeluar marrëdhënie pune në NSH "Agimi" apo se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se rrjedhimisht nuk i njihet e drejta për përfshirje në listën përfundimtare për përfitimin e 20% nga shtija e NSH "Agimi".

(vi) Për parashtruesin Alush Gojani (KI170/19) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka qenë i diskriminuar, nuk ka ofruar "asnjë provë" për ta provuar faktin se ka themeluar marrëdhënie pune në NSH "Agimi" apo se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se rrjedhimisht nuk i njihet e drejta për përfshirje në listën përfundimtare për përfitimin e 20% nga shtija e NSH "Agimi".

(vii) Për parashtruesin Fahredin Zeka, (KI172/19) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka qenë i diskriminuar, nuk ka ofruar "asnjë provë" për ta provuar faktin se ka vazhduar të punojë në NSH "Agimi" apo se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se rrjedhimisht nuk i njihet e drejta për përfshirje në listën përfundimtare për përfitimin e 20% nga shtija e NSH "Agimi".

(viii) Për parashtruesin Genc Roka (KI169/19) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka qenë i diskriminuar, nuk ka ofruar "asnjë provë" për ta provuar faktin se ka

vazhduar të punojë në NSH "Agimi" pas vitit 1999 apo se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se rrjedhimisht nuk i njihet e drejta për përfshirje në listën përfundimtare për përfitimin e 20% nga shtija e NSH "Agimi".

(ix) Për parashtruesen Nerxhivane Peni, (KI166/19) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka qenë e diskriminuar, se ka themeluar marrëdhënie të re të punës në një ndërmarrje tjetër, nuk ka ofruar "asnjë provë" për ta provuar faktin se ka vazhduar të punojë në NSH "Agimi" apo se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se rrjedhimisht nuk i njihet e drejta për përfshirje në listën përfundimtare për përfitimin e 20% nga shtija e NSH "Agimi".

(x) Për parashtruesin Xhavit Meka (KI164/19), Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka qenë i diskriminuar, nuk ka ofruar "asnjë provë" për ta provuar faktin se ka themeluar marrëdhënie pune apo vazhduar punën në NSH "Agimi" pas vitit 1999 apo se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se rrjedhimisht nuk i njihet e drejta për përfshirje në listën përfundimtare për përfitimin e 20% nga shtija e NSH "Agimi".

(xi) Për parashtruesin Muhamet Këndusi (KI160/19), Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se ankesa e tij ishte e paafatshme pasi që ankesa, me postë rekomande, është dorëzuar më 17 janar 2012 kurse lista përfundimtare ka mundur të kundërshtohet në Dhomën e Posaçme më së largu deri më 14 janar 2012.

(xii) Për parashtruesen Sabire Rudi (KI168/19), konstatoi se nuk ka ofruar "asnjë provë" për ta provuar faktin se ka themeluar marrëdhënie pune apo vazhduar punën në NSH "Agimi" apo se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se rrjedhimisht nuk i njihet e drejta për përfshirje në listën përfundimtare për përfitimin e 20% nga shtija e NSH "Agimi."

(xiii) Për parashtruesin Jakup Abaz Agaj (KI178/19), Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se arsyet e dhëna nga Kolegji i

Specializuar i Dhomës së Posaçme për hedhjen e ankesës të paafatshme sepse ai nuk i është përmbajtur dispozitës së nenit 10.6 pika (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme po ashtu shtoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar ndonjë provë për ta arsyetuar mos paraqitjen e ankesës brenda afatit ligjor.

(xiv) Për parashtruesen Elvane Sylafeta (KI171/19), Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se parashtruesja nuk ka "deponuar" asnjë dëshmi për të provuar se ishte punëtore e NSH "Agimi" siç parashikohet me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata,

kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

LIGJI Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 10
Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet

[...]
11. Në rastet kur kolegji i apelit pranon dhe merr përsipër vendosjen mbi një apel, rregullat në vijim respektohen fuqimisht: 11.1. kolegji i apelit nuk mund të ndryshojë, anulojë, rikthejë apo përndryshe të ndërrojë, në çfarëdo mënyrë, gjetjet faktike të bëra nga një gjykatë, kolegj i specializuar, nën-kolegj apo gjyqtar i vetëm, përveç nëse kolegji i apelit përcakton që ajo gjetje faktike është qartësisht e gabueshme. Gjetja faktike nuk vlerësohet të jetë qartësisht e gabueshme nëse ajo gjetje faktike mbështetet me interpretim të arsyeshëm të dosjes së procedurave gjyqësore dhe provave të parashtruara gjatë atyre procedurave; si dhe 11.2. kolegji i apelit bën shqyrtim, prej fillimit, të secilës çështje që ngrihet nga apeluesi apo pala kundërshtare në parashtresat e tij/saj me shkrim.
[...]

Shtojca e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Rregullorja e Punës e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 36
Rregullat e përgjithshme mbi provat

[...]
3. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Neni 68

Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime

1. Përveç nëse nuk përcaktohet saktësisht me këtë nen, procedura për lëndët që bazohen në ankesat që bien nën paragrafin 1.6. të nenit 4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme do të ndjek rregullat e tjera procedurale të përshkruara në këtë Shtojcë e që Dhoma e Posaçme i zbaton mutatis mutandis nëse i vlerëson si të domosdoshme dhe në interes të drejtësisë.
2. Pas pranimit të listës së të punësuarve me të drejta legjitime në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo në bazë të çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas datës së shpalljes, duke kërkuar përfshirjen në një listë të tillë dhe/apo duke sfiduar përfshirjen e një apo më shumë personave tjerë në një listë të tillë. Personi i cili parashtron një kërkesë apo kundërshtim të tillë, do të përfshijë aty në deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështesin kërkesën apo kundërshtimin e tillë; ai person ka barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në kërkesë dhe/apo në kundërshtim.
[...]
6. Agjencia shpallë listën e saj përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime në mbështetje të paragrafit 5. të këtij neni e në përputhje me nenin 10.6. të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, ose në pajtim me çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas ditës së shpalljes për të kundërshtuar në listë të tillë dhe/apo në lidhje me shpërndarjen e fondeve të mbledhura nga Agjencia për personat e identifikuar në atë listë. Ankuesi(t) që parashtrojnë një ankesë të tillë përfshijnë një deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështetin ankesën e tillë; personat që ankohen kanë barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në ankesë.
[...]
11. Kolegji gjegjës i Specializuar, me nismë të vet apo në bazë të një kërkese me shkrim nga ankuesi(t) apo Agjencia, mund të vendos për mbajtjen e një apo më shumë seancave gojore lidhur me çështjen. Nëse mbahet një seance gojore, atëherë Kolegji Specializuar do të udhëzojë Regjistër mbajtësin që, së paku pesë (5) ditë më herët para seancës gojore, t"i dorëzojë palëve një njoftim me shkrim për kohën dhe ditën e seancës së tillë.
[...]

14. Kolegji i Apelit zgjidhë të gjitha apelet e tilla urgjentisht.

Neni 64
Procedurat e ankesës me gojë

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkese për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.
[...]

Neni 65
Paraqitja e provave të reja

Në rrethana të jashtëzakonshme dhe për arsye që dëshmohen mirë, Kolegji i Apelit mund t"i lejoj një pale paraqitjen e provave të reja që nuk kanë qenë në dispozicion të palës gjatë procedurës së shkallës së parë për vlerësimin e provave. Kërkesa me shkrim për një leje të tillë duhet së pari t"i dorëzohet Kolegjit të Apelit dhe duhet t"i dorëzohet palëve tjera jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së seancës kur propozohet paraqitja e këtyre provave. Kolegji i Apelit mund të autorizojë paraqitjen e provave të reja nëse vlerëson se në këtë mënyrë drejtësia do të vihet në vend.

Rregullore Nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në Pronësi Shoqërore

Neni 10
Të Drejtat E të punësuarve

[...]
10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilit pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qënë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.

[...]

Rregullore Nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores Nr. 2003/ 13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore

Neni 1
Ndryshimet

Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje,
[...]
B. Nenet 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 ndryshohen si vijon:
[...]
10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit apo të fillimit të procedurës së likuidimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vite. Kjo kërkesë nuk i përjashton punëtorët nga paraqitja e ankesës në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6., të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar po të mos kishin qenë të diskriminuar.
[...]

Ligji Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 69
Procedurat e ankesës me gojë

1. *Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkese për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.*
[...]

Ligji Nr. 2004/3 kundër Diskriminimit

Neni 8
Barra e provave

8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.
8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda te tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

24. Parashtruesit e kërkesave pretendojnë shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

25. Lidhur me pretendimin për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesit e kërkesave pohojnë se Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme është dashur që të mbajë seancë publike duke i ftuar të gjithë ankuesit për t'i paraqitur drejtpërdrejtë dhe në mënyrë transparente pretendimet dhe provat e tyre, sidomos, duke pasur parasysh faktin se Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme për pjesën dërmuese të tyre kishte njohur të drejtën për përfitim nga 20% e shitjes së NSH "Agimi" Gjakovë. Parashtruesit e kërkesave po ashtu pretendojnë se Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme është dashur ta kthej çështjen në rigjykim dhe rivendosje në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme. Sipas parashtrueseve të kërkesave defektet e lartpërmendura të procesit gjyqësor në Dhomën e Posaçme kanë rezultuar me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

26. Parashtruesi i kërkesës nr. KI171/19 po ashtu pretendon cenim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

27. Lidhur me pretendimin për diskriminim, Parashtruesit e kërkesave pretendojnë se diskriminimi konsiston në faktin se punëtorët me të drejta legjitime janë larguar lista përfundimtare e punëtorëve me të

drejta për përfitim nga shitja e NSH "Agimi" Gjakovë dhe jo në baza etnike siç ka arsyetuar Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme.

28. Përfundimisht parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata: (i) t'i deklarojë kërkesat të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; (iii) ta shpall të pavlefshëm Aktgjykimin të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019 dhe të njëjtin ta kthej për rigjykim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
>
> *[...]*

31. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

> *Neni 48*
> *[Saktësimi i kërkesës]*
>
> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

32. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (2) [Kriteret e pranueshmërisë]të Rregullores së punës, që specifikon:

"[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dështon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

33. Për sa i përket kërkesës KI178/9 të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës Jakup Abaz Agaj, Gjykata vlerëson se pretendimet e këtij parashtruesi lidhur me të drejtën për përfitim nga 20% të shitjes së NSH "Agimi" kanë qenë të shpallura të paafatshme në procedurat e zhvilluara në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Nga dokumentet e dorëzuara, rezulton se parashtruesi i kërkesës KI178/19 (Jakup Abaz Agaj) nuk kishte paraqitur ankesën në pajtim me afatin ligjor të përcaktuar me nenin 10.6, pika (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, dhe po ashtu, nuk kishte bashkangjitur ndonjë propozim në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së dhe as në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së për lëshimin e afatit me qëllim të vlerësimit të arsyes për lëshim të afatit nga DHPGJS-ja.

34. Gjykata vëren se përveç pretendimit se aktgjykimet e kontestuara të DHPGJS-së nuk i janë dorëzuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, parashtruesi i kërkesës KI178/19 (Jakup Abaz Agaj) nuk ka sjellë ndonjë provë se është vonuar në paraqitjen e ankesave pa fajin e tij.

35. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit të kërkesës KI178/19 (Jakup Abaz Agaj) duhet të refuzohet qartazi e pabazuar siç specifikohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

36. Gjykata po ashtu thekson se parashtruesit të kërkesës KI160/19 (Muhamet Këndusi) Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ia ka njohur të drejtën për përfitim nga 20% i privatizimit të NSH "Agimi" Gjakovë dhe nuk ka kontestuar nëse ankesa e parashtruesit të kërkesës KI160/19 është e paafatshme. Mirëpo, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së kishte konstatuar se ankesa e parashtruesit të kërkesës KI160/19 tek

Kolegji i Specializuar është e paafatshme, për shkak se me postë rekomande është dorëzuar më 17 janar 2012 ndërsa afati ligjor për paraqitje të ankesës ka qenë deri më 14 janar 2012.

37. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se situata e parashtruesit të kërkesës KI160/19 (Muhamet Këndusi) dallon substancialisht nga situata e parashtruesit të kërkesës KI178/19 (Jakup Abaz Agaj), për shkak se: (i) parashtruesit të kërkesës KI160/19 (Muhamet Këndusi), Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ia ka njohur të drejtën për përfitim nga 20 % i privatizimit të NSH "Agimi" Gjakovë; (ii) më vonë, pas ankesës së AKP-së, e drejta në fjalë iu refuzua parashtruesit të kërkesës KI160/19 nga Kolegji i Apelit me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit ligjor; (iii) kurse ankesa e parashtruesit të kërkesës KI178/19 (Jakup Abaz Agaj) është refuzuar e paafatshme në të dyja shkallët, pra nga Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së përkatësisht.

38. Gjykata duke vlerësuar situatën e parashtruesit të KI160/19 (Muhamet Këndusi), konsideron se i njëjti të paktën ka pasur pritje legjitime që të dëgjohet nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së për të gjitha çështjet qendrore të ankesës së tij duke përfshirë edhe shpjegimin eventual lidhur me afatin ligjor.

39. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa KI160/19 e parashtruesit Muhamet Këndusi duhet të gjykohet në merita për sa i përket të drejtës për t'u dëgjuar siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.

40. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave të parashtruesve tjerë, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesave janë palë të autorizuara, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

41. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Veç kësaj, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të

Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

42. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me privatizimin e ndërmarrjes shoqërore NSH "Agimi" në Gjakovë, dhe të drejtat e punëtorëve përkatës për t'iu njohur statusi i punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga ky privatizim, siç është përcaktuar në nenin 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, dhe paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores 2003/13 e ndryshuar me Rregulloren nr. 2004/45. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se ndërmarrja e lartcekur shoqërore ishte privatizuar më 15 shtator 2010, datë kjo në të cilën gjithashtu parashtruesit e kërkesës përmes shkresave individuale ishin njoftuar se "*pasoja shitjes së aseteve kryesore është përfundimi i punësimit tuaj*" dhe se i njëjti "*përfundon menjëherë*". Parashtruesit e kërkesës më pas kishin kontestuar mospërfshirjen e tyre në Listën e Përkohshme të AKP-së për punëtorët me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi". Këto ankesa ishin refuzuar. Në vijim, parashtruesit e kërkesës kishin iniciuar padi në Kolegjin e Specializuar, duke kontestuar Vendimin e AKP-së, edhe përkitazi me vërtetimin e fakteve edhe interpretimin e ligjit. Të njëjtit kishin pretenduar se ishin diskriminuar dhe të gjithë kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore para Kolegjit të Specializuar. Ky i fundit, kishte refuzuar kërkesën për seancë dëgjimore me arsyetimin se *"faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaft të qarta"*, dhe u kishte dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës, me përjashtim të parashtruesve të kërkesës KI171/19 (Elvane Sylafeta) dhe KI178/19 (Jakup Abaz Agaj), duke konstatuar se të njëjtit ishin diskriminuar. Kolegji i Specializuar, gjithashtu ndër të tjera, kishte theksuar se në mungesë të diskriminimit, parashtruesit e kërkesës, do t'i kishin plotësuar kriteret e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr.2003/13, si punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi".

43. Pas nxjerrjes së këtij Aktgjykimi, ankesë në Kolegj të Apelit kishin paraqitur (i) Jakup Abaz Agaj (KI178/19) dhe Elvane Sylafeta (KI171/19), të vetmit parashtrues ankesën e të cilëve Kolegji i Specializuar e kishte refuzuar si të pabazuar përkatësisht të paafatshme. (ii) AKP-ja. As të parët as i dyti, nuk kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. Në gusht të vitit 2019, Kolegji i Apelit, kishte nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar, përmes të cilit kishte

miratuar ankesën e AKP-së dhe kishte refuzuar ankesën e Elvane Sylafetës dhe Jakup Abaz Agajt, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe për pasojë, duke hequr "nga lista e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të NSH-së "Agimi" Gjakovë", të gjithë parashtruesit e kërkesës. Kolegji i Apelit, kishte theksuar se kishte vendosur të "heq dorë nga pjesa e seancës gojore", duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 (Procedura e ankesës me gojë) të Ligjit nr. 06/L-086 për DHPGJS-në. Ndërsa, përkitazi me meritat e çështjes, (i) kishte konstatuar se provat e paraqitura nga palët përkatëse nuk dëshmojnë se të njëjtit i plotësojnë kushtet ligjore të përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13 për t'iu njohur të drejtat përkatëse; dhe (ii) kishte theksuar se interpretimi i diskriminimit nga Kolegji i Specializuar është në kundërshtim me "të drejtën precedentale" të DHPGJS-së. Këto konstatime të Kolegjit të Apelit, parashtruesit e kërkesës i kontestojnë para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Përkitazi me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës, siç është sqaruar më lart, pretendojnë se Kolegji i Apelit ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, (i) pa një seancë dëgjimore; (ii) pa arsyetim të mjaftueshëm; (iii) në interpretim arbitrar të ligjit; dhe (iv) në shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

44. Këto pretendime, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

45. Gjykata, në këtë aspekt, do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit. Për këtë qëllim, në vijim, Gjykata (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore siç është e garantuar përmes neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së; dhe më pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(i) Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore

46. Karakteri publik i procedurave para organeve gjyqësore të referuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, mbron palët ndërgjyqëse nga administrimi i drejtësisë në fshehtësi, në mungesë të një shqyrtimi publik. Publiciteti i procedurave gjyqësore është gjithashtu një nga mekanizmat kryesor përmes të cilës ruhet besimi në drejtësi. Një parim i tillë, për më tepër, kontribuon në arritjen e qëllimeve të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike të mishëruara në Kushtetutë dhe KEDNJ (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 381 deri 404 dhe referencat e përdoruara aty).

47. Në parim, palët ndërgjyqëse kanë të drejtë për një seancë dëgjimore publike, por një detyrim i tillë nuk është absolut. Për aq sa është relevante për rrethanat e tanishme, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka zhvilluar parimet kryesore që kanë të bëjnë me (i) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë; (ii) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë dhe të tretë; (iii) parimet në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme; dhe (iv) nëse mungesa e dëgjimit në shkallën e parë mund të korrigjohet përmes një seance dëgjimore në një shkallë më të lartë dhe kriteret përkatëse për të bërë këtë vlerësim. Sidoqoftë, në të gjitha rrethanat, mungesa e një seancë dëgjimore duhet të jetë e arsyetuar nga gjykata përkatëse.

48. Për sa i përket çështjes së parë, përkatësisht detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë, GJEDNJ ka theksuar se në procedurat para një gjykate të shkallës së parë dhe të vetme, e drejta për një seancë dëgjimore është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, Fredin kundër Suedisë (nr. 2), Aktgjykim i 23 shkurtit 1994, paragrafët 21-22; Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2), Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 46; Göç kundër Turqisë, Aktgjykim i 11 korrikut 2002, paragrafi 47; dhe Selmani dhe të tjerët kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Aktgjykim i 9 shkurtit 2017, paragrafët 37-39). Përjashtim nga ky parim i përgjithshëm, përbëjnë rastet në të cilat "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore" në shkallën e parë dhe të vetme (shih, në këtë aspekt, rastet e GJEDNJ-së, Hesse-Anger dhe Anger kundër Gjermanisë, Vendim i 17 majit 2001; Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë, Aktgjykim i 13 marsit 2018, paragrafi 36; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për

një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 382 dhe referencat e përdoruara aty). Karakteri i rrethanave të tilla të jashtëzakonshme buron nga natyra e çështjeve që ngërthen një rast, për shembull, rastet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës shumë teknike (shih rastin e GJEDNJ-së, Koottummel kundër Austrisë, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009, paragrafët 19 dhe 20).

49. Për sa i përket çështjes së dytë, përkatësisht detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, Salomonsson kundër Suedisë, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 36). Prandaj, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore. Rrjedhimisht, procedurat lidhur me të cilat është mbajtur një seancë dëgjimore në shkallën e parë dhe lidhur me të cilën, procedurat e shkallës së dytë kanë përfshirë vetëm çështje ligji dhe jo fakti, në parim, janë në përputhshmëri me garancitë procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse një pale nuk i është dhënë mundësia të dëgjohet personalisht në nivel apeli (shih rastin e GJEDNJ-së, Miller kundër Suedisë, Aktgjykim i 8 shkurtit 2005, paragrafi 30; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 383 dhe referencat e përdoruara aty). Më saktësisht, në raste kur para gjykatave me juridiksion apeli shqyrtohen edhe çështje fakti edhe ligji, mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet vetëm përmes "ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme", siç janë definuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Prandaj, përveç nëse "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore", kjo e fundit është e garantuar për palët në të paktën njërin nivel të juridiksionit, bazuar në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 386 dhe referencat e përdoruara aty).

50. Për sa i përket çështjes së tretë, përkatësisht parimeve në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e

domosdoshme, Gjykata i referohet Aktgjykimit të 6 nëntorit 2018 të GJEDNJ-së: Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë, në të cilin Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së, vendosi parimet bazuar në të cilat duhet të vlerësohet domosdoshmëria e një seance dëgjimore. Sipas këtij Aktgjykimi, një seancë dëgjimore nuk është e domosdoshme nëse rasti përkatës (i) ngërthen thjeshtë çështje juridike të një natyre të kufizuar (shih rastet e GJEDNJ-së, Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2), cituar më lartë, paragrafi 49; dhe Valová, Slezák dhe Slezák kundës Sllovakisë, Aktgjykim i qershorit 2004, paragrafët 65-68) ose nuk ngërthen ndonjë ndërlikueshmëri të veçantë (shih rastin e GJEDNJ-së, Varela Assalino kundër Portugalisë, Vendim i 25 prillit 2002); dhe (ii) ngërthen çështje tepër teknike, të cilat trajtohen më mirë me shkrim sesa përmes argumenteve gojore në një seancë dëgjimore; dhe (iii) nuk ngërthen çështje të besueshmërisë së palëve ose fakteve të kontestuara dhe gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme në bazë të parashtresave të palëve dhe materialeve të tjera me shkrim (shih rastet e GJEDNJ-së, Döry kundër Suedisë, Aktgjykim i 12 nëntorit2002, paragrafi 37; dhe Saccoccia kundër Austrisë, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008, paragrafi 73).

51. Në të kundërtën, bazuar në Aktgjykimin e lartpërmendur, një seancë dëgjimore është e domosdoshme nëse rasti përkatës (i) ngërthen nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë (shih rastet e GJEDNJ-së, Malhous kundër Republikës Çeke, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 60; dhe Fischer kundër Austrisë, Aktgjykim i 26 prillit 1995, paragrafi 44); dhe (ii) kërkon që gjykata përkatëse të fitojë një përshtypje personale për palët përkatëse, dhe t'u lejohet të njëjtëve mundësia të sqarojnë gjendjen personale, personalisht ose përmes përfaqësuesit përkatës. Shembuj të kësaj situate përbëjnë rastet kur gjykata duhet të dëgjojë prova nga palët në lidhje me vuajtjet personale në mënyrë që të përcaktojë nivelin e duhur të kompensimit (shih rastet e GJEDNJ-së, Göç kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 51; dhe Lorenzetti kundër Italisë, Aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafi 33) ose duhet të sigurojë informacion në lidhje me karakterin, sjelljen dhe rrezikshmërinë e një pale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, De Tommaso kundër Italisë, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafi 167).

52. Për sa i përket çështjes së katërt, përkatësisht mundësisë së korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë dhe kritereve respektive, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar se në parim, një korrigjim i tillë varet nga kompetencat e gjykatës më të lartë. Nëse kjo e fundit, ka juridiksion të plotë për të shqyrtuar meritat e rastit përkatës, përfshirë edhe

vlerësimin e fakteve, atëherë korrigjimi i mungesës së një seance dëgjimore në shkallë të parë, mund të bëhet në shkallën e dytë (shih rastin e GJEDNJ-së, Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë, cituar më lart, paragrafi 192 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 384 dhe referencat e përdoruara aty).

53. Përfundimisht, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, fakti që palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore nuk do të thotë që të njëjtat kanë hequr dorë nga e drejta për të mbajtur një të tillë (për më shumë, lidhur me heqjen dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore, shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 401 dhe 402 dhe referencat e përdorura aty). Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, një çështje e tillë varet nga karakteristikat e ligjit vendor dhe rrethanat e secilit rast veç e veç (shih rastin e GJEDNJ-së, Göç kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 48; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafi 403 dhe referencat e përdorura aty).

(ii) Aplikimi i parimeve të shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret

54. Gjykata rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së, në parim, garanton mbajtjen e një seance dëgjimore në të paktën njërin nivel të vendimmarrjes. Një e tillë është, në parim, (i) e detyrueshme nëse gjykata e shkallës së parë ka kompetencën e vetme të vendimmarrjes përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit; (ii) jo e detyrueshme në shkallë në dytë nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallë të parë, përkundër faktit që një përcaktim i tillë varet nga karakteristikat e rastit përkatës, për shembull, nëse shkalla e dytë vendos edhe për çështje fakti edhe ligji; dhe (iii) e detyrueshme në shkallë të dytë nëse një e tillë nuk është mbajtur në shkallë të parë, në rastet kur shkalla e dytë ka kompetencë të plotë për të vlerësuar vendimin e shkallës së parë, edhe përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit. Përjashtime nga këto raste, në parim, bëhen vetëm nëse "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore", dhe të cilat GJEDNJ, siç është sqaruar më lart, përmes praktikës së saj gjyqësore i ka përcaktuar si raste që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës së lartë teknike.

55. Bazuar në parimet e shtjelluara më lart, Gjykata në vijim duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar një seancë dëgjimore në Kolegjin e Apelit, mund të rezultojë në konstatimin se të njëjtit kanë hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga një seancë dëgjimore. Nëse përgjigja në këtë çështje rezulton të jetë negative, atëherë Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore" në të dy shkallët e vendimmarrjes, para Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit, respektivisht. Këtë vlerësim Gjykata do të bëjë duke u bazuar edhe në parimet e vendosura përmes Aktgjykimit të Dhomës së Madhe Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë.

a) Nëse parashtruesit e kërkesës kanë hequr dorë nga e drejta e një seance dëgjimore

56. Gjykata në këtë aspekt, rikujton që përmes ankesave individuale të parashtruara në Kolegjin e Specializuar, të gjithë parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. Kolegji i Specializuar kishte refuzuar mbajtjen e të njëjtës, duke theksuar se bazuar në paragrafin 11 të nenit 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-së, seanca dëgjimore nuk ishte e nevojshme sepse "faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaftë të qarta". Siç, është sqaruar tashmë, Kolegji i Specializuar, bazuar në këto "fakte dhe prova", kishte vendosur se parashtruesit e kërkesës, me përjashtim të parashtruesve Elvane Sylafeta (KI171/19) dhe Jakup Abaz Agaj (KI178/19), ishin diskriminuar duke vendosur gjithashtu se të njëjtit duhet të përfshihen në Listën Përfundimtare të AKP-së si punëtorë me të drejta legjitime për të përfituar nga njëzet përqindëshi (20%-it) i privatizimit të ndërmarrjes NSH "Agimi".

57. Në Kolegjin e Apelit ishte ankuar vetëm AKP-ja. Kolegji i Apelit kishte vendosur në favor të AKP-së, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe duke refuzuar ankesat e të gjithë parashtruesve përkitazi me mospërfshirjen në Listën Përfundimtare të AKP-së si rezultat i diskriminimit. Siç është sqaruar më lart, Kolegji i Apelit kishte vendosur të "heq dorë nga pjesa e seancës gojore", duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 të Ligjit nr. 06/L-086për DHPGJS-në.

58. Megjithatë, siç është sqaruar më lart, fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë bërë kërkesë për një seancë dëgjimore, jo detyrimisht do të thotë se të njëjtit kanë hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga një

kërkesës e tillë, dhe gjithashtu mungesa e kësaj kërkese jo detyrimisht e liron gjykatën përkatëse nga detyrimi për mbajtjen e një seancë të tillë.

59. Më saktësisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në rrethanat e rasteve në të cilat palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seancë dëgjimore, GJEDNJ, mes tjerash, vlerëson nëse mungesa e një kërkesë të tillë, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar të një parashtruesi nga e drejta për një seancë dëgjimore. Megjithatë, mungesa e kërkesës për një seancë dëgjimore, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, asnjëherë nuk është faktori i vetëm që përcakton domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance dëgjimore. Në të gjitha rastet, nëse mungesa e kërkesës për seancë dëgjimore e liron një gjykatë nga detyrimi për mbajtjen e një seancë dëgjimore, varet nga (i) specifikat e ligjit të aplikueshëm; dhe (ii) rrethanat e një rasti (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 401 deri 404 dhe referencat e përdoruara aty). Në vijim, Gjykata do të vlerësojë këto dy çështje.

60. Së pari, përkitazi me specifikat e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht Ligjit dhe Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Gjykata rikujton se bazuar në nenin 64 (Procedurat e ankesës me gojë) të të njëjtit ligj, "Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse", në bazë të nismës së tij apo edhe kërkesës me shkrim nga një palë. Neni 69 (Procedurat e ankesës me gojë) i Ligjit Nr. 06/L-086 për DHPGJS, ka të njëjtën përmbajtje. Bazuar në këto dispozita rrjedhimisht, mbajtja e një seancë dëgjimore në nivel apeli, jo detyrimisht varet nga kërkesa e palës. Është gjithashtu detyrë e Kolegjit përkatës, që bazuar në nismën e tij, të vlerësojë nëse rrethanat e një rasti kërkojnë mbajtjen e një seance dëgjimore. Për më tepër, bazuar në nenin 60 (Përmbajtja e ankesës) dhe nenin 65 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të vlerësojë edhe çështjet e ligjit edhe të faktit, dhe për pasojë, është e pajisur me kompetencë të plotë për të vlerësuar mënyrën se si ka vlerësuar faktet instanca më e ulët, përkatësisht Kolegji i Specializuar. Në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Apelit ka vlerësuar faktet dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar edhe përkitazi me vlerësimin e fakteve edhe interpretimin e ligjit, në dëm të parashtruesve të kërkesës. Në rrethana të tilla, duke marrë parasysh dispozitat ligjore, Gjykata nuk mund të konstatojë se mungesa e një seance dëgjimore në Kolegj të Apelit është e justifikuar vetëm si rezultat i mungesës së një kërkese nga palët në procedurë, posaçërisht marrë parasysh faktin që parashtruesit e kërkesës nuk

janë ankuar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, i cili ishte në favor të tyre. Siç është sqaruar më lartë, bazuar në nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në është detyrim i Kolegjit të Apelit që edhe me nismën e tij të vlerësojë nëse mbajtja e një seancë dëgjimore është e detyrueshme, dhe nëse jo, të arsyetoj mos-mbajtjen e së njëjtës (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 61).

61. Së dyti, përkitazi me rrethanat e një rasti, Gjykata rikujton që praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, thekson se mungesa e një kërkese për një seancë dëgjimore, dhe vlerësimi nëse ky fakt mund të rezultojë në konstatimin se pala përkatëse në mënyrë të nënkuptuar ka hequr dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore, duhet të vlerësohet në tërësinë e specifikave të një procedure, dhe jo si argument i vetëm, për të konstatuar nëse mungesa e një seance dëgjimore ka rezultuar ose jo në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

62. Më specifikisht, në rastet kur një palë përkatëse nuk ka kërkuar seancë dëgjimore, GJEDNJ ka vlerësuar nëse mungesa e një kërkese të tillë mund të konsiderohet sikur heqje dorë e nënkuptuar nga një seancë dëgjimore, gjithmonë duke pasur parasysh ligjin e zbatueshëm dhe rrethanat e rastit. Për shembull (i) në rastin Miller kundër Suedisë (Aktgjykim i 6 majit 2005), në të cilin, parashtruesja përkatëse nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të apelit, por e njëjta kishte kërkuar mbajtjen e një seancë dëgjimore në nivel të shkallës së parë, kishte rezultuar në konstatimin e GJEDNJ-së që kërkesa për seancë dëgjimore ishte bërë në fazën "më të duhur e procedurave" dhe për pasojë, GJEDNJ kishte theksuar se nuk mund të konstatohet se pala ka hequr dorë nga kërkesa për seancë dëgjimore në mënyrë të nënkuptuar. Për më tepër, në kombinim me konstatimin se në nivel apeli ishin shqyrtuar edhe çështje fakti edhe ligji, dhe për pasojë natyra e çështjeve në shqyrtim nuk ishte ekskluzivisht ligjore e as teknike, GJEDNJ, konstatoi se nuk ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore, duke konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së: *Miller kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafët 28-37); gjithashtu (ii) në rastin *Salomonsson kundër Zvicrës* (Aktgjykim i 12 shkurtit 2003), në të cilin, parashtruesi përkatës nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore në asnjërën nga instancat, GJEDNJ edhe pse konstatoi se parashtruesi përkatës mund të konsiderohet se ka hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga e drejta në një seancë dëgjimore (shih paragrafin 35 të rastit *Salomonsson kundër Zvicrës*), megjithatë konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së

për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore, sepse konkludoi që në rrethanat e rastit konkret, nuk ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore, posaçërisht marrë parasysh faktin që niveli i apelit shqyrtoi edhe çështje fakti dhe jo vetëm ligji (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 63 dhe rastin e GJEDNJ-së *Salomonsson kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafët 36-40).

63. Në anën tjetër, në rastin, *Goç kundër Turqisë*, GJEDNJ gjithashtu konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, duke refuzuar pretendimet e Qeverisë Turke se (i) rasti ishte i thjeshtë dhe se mund të trajtohej me shpejtësi vetëm në bazë të shkresave të lëndës, veçanërisht për shkak se parashtruesi përkatës përmes ankesës nuk kërkoi sjelljen e ndonjë prove të re; dhe se (ii) parashtruesi përkatës nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore (për faktet e rastit, shih paragrafët 11 deri 26 të rastit të GJEDNJ-së Goç kundër Turqisë). Në shqyrtimin e rastit përkatës, dhe pas vlerësimit nëse në rrethanat e tij ekzistonte ndonjë rrethanë e jashtëzakonshme që do të justifikonte mungesën e një seance dëgjimore, GJEDNJ konstatoi shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, duke theksuar, mes tjerash, se (i) përkundër faktit që parashtruesi përkatës nuk kishte bërë kërkesë për një seancë dëgjimore, nga rrethanat e rastit nuk rezulton se një kërkesë e tillë do të kishte ndonjë perspektivë suksesi; për më tepër që (ii) nuk mund të konsiderohet se parashtruesi përkatës ka hequr dorë nga e drejta e tij për një seancë dëgjimore duke mos kërkuar një të tillë para gjykatës së apelit pasi që kjo e fundit nuk kishte juridiksion të plotë për të përcaktuar shumën e kompensimit; (iii) parashtruesit përkatës nuk i ishte dhënë mundësia të dëgjohet as para shkallës më të ulët dhe e cila kishte kompetencë edhe për vlerësimin e fakteve edhe të ligjit; dhe (iv) çështja thelbësore, në rrethanat e këtij rasti, ishte nëse parashtruesit përkatës duhet t'i ofrohej një seancë dëgjimore para një gjykate e cila ishte përgjegjëse për vërtetimin e fakteve të rastit (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 Parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 64 dhe për arsyetimin e rastit, shih paragrafët 43 deri 52 të rastit *Goç kundër Turqisë*).

64. Për dallim, në raste tjera, GJEDNJ ka konstatuar se fakti që një parashtrues nuk ka kërkuar një seancë dëgjimore mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar nga kjo e drejtë, mirëpo

gjithmonë së bashku me vlerësimin nëse, në rrethanat e një rasti, ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të e justifikonin mungesën e një seancë dëgjimore. Për shembull, në rastet *Schuler-Zgraggen kundër Zvicrës* (Aktgjykim i 24 qershorit 1993) dhe *Dory kundër Suedisë* (Aktgjykim i 12 shkurtit 2003), në të cilat, parashtruesit përkatës nuk kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore, GJEDNJ kishte vlerësuar se të njëjtit kishin hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga e drejtat në një seancë dëgjimore. Megjithatë, këtë konstatim GJEDNJ e kishte arritur, vetëm në ndërlidhje me konstatimin se rrethanat e rastit përkatës ishin të "natyrës teknike", dhe rrjedhimisht ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që e justifikojnë mungesës e një seance dëgjimore, duke mos konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miller kundër Suedisë*, cituar më lartë, paragrafët 28-37; *Dory kundër Suedisë*, cituar më lartë, paragrafët 36-45). Ngjashëm, GJEDNJ kishte vepruar edhe në rastin *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës* (Aktgjykimi i 19 prillit 2007), në të cilin nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 Parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 65 dhe për arsyetimet, përkitazi me seancën dëgjimore, shih paragrafët 73 deri 75 në rastin *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës*).

65. Gjykata gjithashtu bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, thekson se fakti që para gjykatave përkatëse ka mbizotëruar praktikë e zhvillimit të procedurës më shkrim dhe pa seanca dëgjimore, nuk është marrë parasysh nga GJEDNJ si fakt i vetëm bazuar në të cilin mund të anashkalohet një seancë dëgjimore, pa marrë parasysh rrethanat specifike të një rasti. Për shembull, në rastin Madamus kundër Gjermanisë (Aktgjykim i 9 qershorit 2016), kishte shqyrtuar edhe pretendime bazuar në të cilat, ligji i aplikueshëm parashihte mbajtjen e seancave dëgjimore si përjashtim dhe jo si rregull, për më tepër që bazuar në praktikën përkatëse, gjykata vendimi i së cilës kontestohej para GJEDNJ-së, asnjëherë nuk kishte mbajtur një seancë dëgjimore. Përkundër këtij fakti, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, pasi vlerësoi dhe konstatoi që në rrethanat e këtij rasti nuk ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e mbajtjes së një seancë dëgjimore (shih paragrafët 25 deri më 33 të rastit *Madamus kundër Gjermanisë*).

66. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, (i) parashtruesve të kërkesës nuk iu është dhënë mundësi të dëgjohen para Kolegjit të Specializuar, me kompetencë për vlerësimin e fakteve dhe të ligjit,

përkundër kërkesës së tyre; (ii) parashtruesit e kërkesës nuk ishin ankuar në Kolegjit e Apelit sepse vendimi i Kolegjit të Specializuar ishte në favor të tyre; (iii) procedura në Kolegjin i Apelit ishte iniciuar përmes ankesës së AKP-së; (iv) Kolegji i Apelit, kishte "hequr dorë nga seanca", duke u referuar në nenin 69 të Ligjit 06/L-086 për DHPGJS-në, nen ky identik me nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, të cilët thjeshtë përcaktojnë se "Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse"; dhe (v) Kolegji i Apelit, kishte shqyrtuar të gjitha faktet e rastit, duke përshirë ankesat e parashtruesve të dorëzuara në shkallë të parë, dhe duke theksuar se nuk pajtohet as me vlerësimin e fakteve dhe as me interpretimin e ligjit nga gjykata e shkallës më të ulët, kishte ndryshuar në tërësi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, duke i hequr të gjithë parashtruesit e kërkesës nga Lista e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar nga njëzet përqindëshi (20%-it) i privatizimit të ndërmarrjes NSH "Agimi".

67. Në rrethana të tilla, Gjykata nuk mund të konstatojë se mungesa e kërkesës së parashtruesve të kërkesës për mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar e tyre nga e drejta për një seancë dëgjimore. Gjykata rikujton se në të gjitha rastet në të cilat GJEDNJ kishte arritur në një konstatim i tillë, e kishte bërë në ndërlidhje me faktin se rrethanat e rasteve ndërlidheshin me çështje të natyrës ekskluzivisht ligjore ose të natyrës teknike, dhe rrjedhimisht "ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seancë dëgjimore". Për pasojë dhe në vijim, Gjykata duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, "ekzistojnë rrethanat të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seance dëgjimore", përkatësisht nëse natyra e çështjeve në vlerësim para Kolegjit të Apelit, mund të klasifikohet si "ekskluzivisht ligjore apo e natyrës së lartë teknike" (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 68).

b) Nëse në rrethanat e rastit konkret ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e seancës dëgjimore

68. Gjykata rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, palët kanë të drejtë në seancë dëgjimore në të paktën njërën instancë. Kjo instancë, është kryesisht instanca e parë, dhe ajo e cila e ka

juridiksionin për të vendosur edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji. Në këtë kontekst, përkitazi me detyrimin për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë. Në parim, nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallën e parë, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore. Në parim, përjashtim nga e drejta për një seancë dëgjimore, janë vetëm ato raste, në të cilat përcaktohet se ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore. Këto rrethana, siç është sqaruar më lart, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së i ka klasifikuar si raste të cilat ndërlidhen me çështje ekskluzivisht ligjore apo të natyrës së lartë teknike (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 69).

69. Për shembull, çështjet që ndërlidhen me sigurime sociale, GJEDNJ, kryesisht, i ka klasifikuar si çështje të natyrës teknike, në të cilat, jo detyrimisht është e domosdoshme një seancë dëgjimore. Sigurisht, nga ky rregull ka përjashtime. Në çdo rast, shqyrtohen rrethanat konkrete të një rasti. Për shembull, GJEDNJ nuk kishte konstatuar shkelje në rastet Schuler-Zgraggen kundër Zvicrës dhe Dory kundër Suedisë, por kishte konstatuar shkelje në rastin Miller kundër Suedisë dhe Salomonsson kundër Zvicrës, edhe pse të gjitha ndërlidheshin me çështje të sigurimeve sociale.

70. Në mënyrë të ngjashme, GJEDNJ vepron edhe në ato raste në të cilat çështjet para Gjykatës përkatëse janë ekskluzivisht ligjore, dhe nuk përfshijnë fakte kontestuese. Për shembull, në rastin Saccoccia kundër Austrisë (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore, pasi konstatoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin çështje fakti, por vetëm çështje të limituar të natyrës ligjore (Saccoccia kundër Austrisë, cituar më lartë, paragrafi 78), ndërsa në rastin Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2) (Aktgjykim i 19 shkurtit 1998), gjithashtu GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore, pasi konstatoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin as çështje ligji e as fakti (shih rastin e

GJEDNJ-së, Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2), cituar më lartë, paragrafi 49).

71. Përkundrazi në raste tjera e në të cilat, GJEDNJ përcaktoi se çështjet para gjykatave përkatëse ngërthenin edhe çështje fakti edhe ligji, ajo nuk konstatoi se ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore. Për shembull, në rastet Malhous kundër Republikës Çeke (Aktgjykim i 12 korrikut 2001), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, pasi përcaktoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin vetëm çështje ligji por edhe fakti, përkatësisht vlerësimin nëse autoriteti më i ulët i kishte vlerësuar faktet në mënyrë të drejtë (shih rastin e GJEDNJ-së Malhous kundër Republikës Çeke, cituar më lartë, paragrafi 60). Në të njëjtën mënyrë, në rastin Koottummel kundër Austrisë (Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për mungesë të një seance dëgjimore, sepse konstatoi së çështjet para saj nuk mund të kualifikoheshin si çështje të natyrës ekskluzivisht ligjore ose të natyrës teknike, që do të mund të konsistonin në rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore (shih rastin e GJEDNJ-së, Koottummel kundër Austrisë, cituar më lartë paragrafët 20 dhe 21).

72. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht rikujton që Kolegji i Apelit, ka juridiksion edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji. Bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 (Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet) të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Ligji për DHPGJS-në) dhe paragrafin 4 të nenit 64 (Procedurat e ankesës me gojë) dhe nenin 65 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, palët, ndër tjerash, kanë mundësinë që të paraqesin ankesat para Kolegjit të Apelit edhe përkitazi me çështjet e ligjit edhe të fakteve, duke përfshirë edhe mundësinë që të paraqiten prova të reja (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 73)..

73. Për më tepër, në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar të gjitha faktet e paraqitura përmes (i) ankesës fillestare të parashtruesve të kërkesës në Kolegjin e Specializuar dhe përgjigjet në ankesë të AKP-së; dhe (ii) ankesës së AKP-së dhe të Elvane Sylafetës (KI171/19) dhe Jakup Abaz Agajt (KI178/19) në Kolegjin e Apelit dhe të përgjigjeve përkatëse në ankesë të parashtruesve të kërkesës.

Përkundër faktit që Kolegji i Specializuar kishte vlerësuar se provat "janë të qarta" duke u dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës, Kolegji i Apelit kishte konstatuar të kundërtën bazuar në po të njëjtat prova.

74. Gjykata gjithashtu rikujton që bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 të Ligjit nr. për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit është i kufizuar në ndërrimin e vlerësimit të gjendjes faktike të bërë nga Kolegji i Specializuar, përpos nëse përcakton që gjetjet faktike të gjykatës më të ultë janë "qartësisht të gabueshme", rregull kjo që sipas të njëjtit nen duhet të "respektohet fuqimisht". Një arsyetim i tillë, nuk gjendet në Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit. Ky i fundit, thjesht nuk ishte pajtuar më vlerësimin e provave nga Kolegji i Specializuar, dhe gjithashtu kishte konstatuar se interpretimi të cilin Kolegji i Specializuar ia ka bërë pretendimeve përkitazi me diskriminim, është në kundërshtim me "të drejtën precedentale".

75. Gjykata më tej vëren, se bazuar në nenin 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, në rast të ankesave lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, barra e provës bie mbi parashtruesit e kërkesës përkatëse para Kolegjit të Specializuar. Po ashtu, barra e të provuarit për kundërshtuesin e një kërkesë të tillë, bie mbi kundërshtuesin, përkatësisht AKP-në, në rrethanat e rastit konkret. Para Kolegjit të Apelit, barra e të provuarit gjithashtu bie mbi parashtruesin e ankesës përkatëse. Por, rrethanat e rastit konkret, gjithashtu, në esencë ndërlidhen me pretendime për diskriminimin. Në rast të pretendimeve të tilla, barra e të provuarit, bazuar në nenin 8 (Barra e provave) të Ligjit kundër Diskriminimit, bie mbi palën e paditur, përkatësisht AKP-në, dhe jo parashtruesit e kërkesës (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 76).

76. Në rrethanat e tilla, në të cilat (i) Kolegji i Apelit ka shqyrtuar edhe çështje fakti edhe ligji; (ii) në të cilat përkitazi me faktet, barra e të provuarit se i plotësojnë kriteret e paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13, në parim bie mbi parashtruesit e kërkesës, ndërsa barra e të provuarit lidhur me diskriminimin bie mbi AKP-në; dhe (iii) Kolegji i Apelit interpreton të njëjtat fakte të paraqitura nga palët në mënyrë të ndryshme nga mënyra se si i ka interpretuar Kolegji i Specializuar, duke ndryshuar Aktgjykimin në dëm të palëve, përkundër faktit që një mundësi e tillë bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-033 për DHPGJS-në, i është njohur vetëm përjashtimit, me kushtin që të argumentojë që autoriteti më i ulët,

përkatësisht Kolegji i Specializuar, ka bërë interpretim "qartësisht të gabueshëm", Gjykata vlerëson se është e pakontestueshme që çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk është (i) as çështje ekskluzivisht ligjore; dhe (ii) as e natyrës teknike. Përkundrazi, çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit ngërthente çështje të rëndësishme faktike dhe ligjore. Në një situatë të tillë, rëndësia për palët që t'iu ofrohet një seancë kontradiktore përpara organit që kryen rishikimin gjyqësor nuk duhet të nënvlerësohet. Për pasojë, Gjykata duhet të konstatojë, se në rrethanat e rastit konkret, nuk ekzistojnë rrethana të cilat do e justifikonin mungesën e seancës dëgjimore (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 77)..

77. Në mbështetje të këtij konstatimi, Gjykata rikujton që përmes Aktgjykimit të GJEDNJ-së, Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë, specifikisht ishte përcaktuar se një seancë dëgjimore është e domosdoshme në rrethana që ngërthejnë nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë. Kjo vlen posaçërisht në rrethana në të cilat, një seancë dëgjimore nuk është mbajtur as para shkallës më të ulët, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret.

78. Në fakt, në disa raste GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së kur një seancë dëgjimore nuk ishte mbajtur në një gjykatë me juridiksion apeli, edhe atëherë kur një seancë dëgjimore ishte mbajtur në instancën më të ulët, përkundër faktit se vlerësimi i domosdoshmërisë së seancës dëgjimore në nivel apeli është më pak rigoroz atëherë kur një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallën e parë. Për shembull, në Aktgjykimin Helmers kundër Suedisë, GJEDNJ shqyrtoi një rast në të cilin parashtruesit përkatës i ishte mundësuar një seancë dëgjimore në shkallën e parë, por jo në nivelin e apelit, e cila kishte kompetencë të vlerësonte edhe ligjin edhe faktet në rrethanat e rastit përkatës. Në këtë rast, GJEDNJ kishte ritheksuar se (i) garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, jo detyrimisht garantojnë një seancë dëgjimore në nivel apeli, nëse një e tillë është mbajtur në shkallën e parë; dhe (ii) në marrjen e këtij vendimi, gjykata përkatëse duhet gjithashtu të ketë parasysh nevojën për trajtimin ekspeditiv të rasteve si dhe të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Megjithatë, duke vënë theks në faktin se një përcaktim i tillë varet nga natyra e çështjeve që ngërthen një rast dhe nevojën për ekzistimin e rrethanave të veçanta në mënyrë që të justifikohet mungesa e një seance dëgjimore, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6

të KEDNJ-së (për arsyetimin përkatës të rastit, shih paragrafët 31 deri 39 të rastit Helmers kundër Suedisë).

79. Në fund, Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se Kolegji i Apelit nuk kishte arsyetuar "heqjen dorë nga seanca", por ishte mjaftuar vetëm me referim në nenin 69 të Ligjit 06/L-086 për DHPGJS-në. Ky i fundit, siç është sqaruar më lart, thjesht përcakton kompetencën e Kolegjit të Apelit për të vendosur për mbajtjen e seancës dëgjimore bazuar në nismën e tij ose me kërkesë të palës. Aktgjykimi përkatës nuk përmban asnjë sqarim shtesë lidhur me vendimin e Kolegjit të Apelit për të "hequr dorë nga seanca". Në këtë kontekst, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me mungesën e një seance dëgjimore, duhet të shqyrtohet edhe nëse refuzimi i mbajtjes së një seance të tillë është i arsyetuar. Për shembull në rastin e GJEDNJ-së Pönkä kundër Estonisë, (Aktgjykimi i 8 nëntorit 2016), e që ndërlidhej me zhvillimin e një procedure të thjeshtuar (e rezervuar për padi të vogla), GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, sepse gjykata përkatëse nuk kishte arsyetuar mungesën e një seance dëgjimore (shih rastin e GJEDNJ-së, Pönkä kundër Estonisë, cituar më lart, paragrafët 37-40). Gjithashtu, në rastin e GJEDNJ-së, Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë, cituar më lart, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, ndër të tjerash edhe pse gjykata përkatëse nuk kishte dhënë shpjegim për mosmbajtjen e një seance dëgjimore (shih rastin e GJEDNJ-së, Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë, cituar më lart, paragrafi 44). Në kontekst të mungesës së arsyetimit të mosmbajtjes së një seance dëgjimore, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, në mënyrë të vazhdueshme, ndër të tjera, ka theksuar se nga mungesa e arsyetimit rreth nevojës për mbajtjen e një seance dëgjimore, i pamundëson gjykatës më të lartë, të vlerësojë nëse një mundësi e tillë thjeshtë është neglizhuar, apo cilat janë argumentet bazuar në të cilat gjykata ka anashkaluar një mundësi të tillë në raport me rrethanat që ngre një rast i caktuar (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 80; dhe rastin e GJENDJ-së Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë ,paragrafi 44 dhe referencat e përdoruara aty).

80. Prandaj, dhe në përfundim, Gjykata, duke marrë parasysh që (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar shprehimisht mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton se të njëjtit në mënyrë të nënkuptuar kanë hequr dorë nga kjo e drejtë, posaçërisht duke marrë parasysh që të njëjtit nuk kanë iniciuar ankesën para Kolegjit të Apelit dhe gjithashtu mungesa e kësaj

kërkesë, nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi për vlerësimin e domosdoshmërisë së një seance dëgjimore; (ii) përkundër kërkesës specifike të parashtruesve përkatës për seancë dëgjimore para Kolegjit të Specializuar, një e tillë nuk ishte mbajtur dhe rrjedhimisht, standardet që aplikohen për domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit janë më rigoroze, sepse, në parim, palët kanë të drejtë në një seancë dëgjimore të paktën para një instance gjyqësore; (iii) çështjet në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk mund të kualifikohen as si çështje ekskluzivisht ligjore dhe as çështje të natyrës teknike, por përkundrazi si çështje të faktit dhe ligjit; (iv) Kolegji i Apelit kishte vlerësuar mënyrën se si instanca më e ultë, përkatësisht Kolegji i Specializuar kishte bërë vlerësimin e fakteve, duke e ndryshuar Aktgjykimin e tij në dëm të parashtruesve të kërkesës; dhe (v) Kolegji i Apelit nuk e kishte arsyetuar "heqjen dorë nga seanca"; konstaton se në rastin konkret nuk kanë "ekzistuar rrethana të jashtëzakonshme për të justifikuar mungesën e një seance dëgjimore", dhe për pasojë, Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 81).

81. Gjykata në fund gjithashtu thekson, se duke marrë parasysh që tashmë ka konstatuar që Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së rrethanave të jashtëzakonshme të cilat do të mund të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës. Pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Për më tepër, duke marrë parasysh që Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për të shqyrtuar vendimet e kontestuara të Kolegjit të Specializuar bazuar në ligjet e aplikueshme për DHPGJS-në, i njëjti ka mundësinë e korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 82).

82. Konstatimi i Gjykatës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet

ekskluzivisht me mungesën e seancës dëgjimore, siç është sqaruar në këtë Aktgjykim, dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me dhe as nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

Përfundim

83. Gjykata ka vlerësuar pretendimet e parashtruesve te kërkesës, përkitazi me mungesën e seancës dëgjimore në rrethanat e rastit të tyre, si një ndër garancitë e përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenit 6 të KEDNJ-së, duke mbështetur këtë vlerësim në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

84. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht ka shtjelluar parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika e saj gjyqësore dhe ajo e GJEDNJ-së, përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore, duke i sqaruar rrethanat në të cilat një e tillë është e domosdoshme, bazuar mes tjerash, në Aktgjykimin e Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë. Gjykata ka sqaruar, mes tjerash, se (i) mungesa e kërkesës së një pale për seancë dëgjimore jo detyrimisht nënkupton heqjen dorë nga një e drejtë të tillë dhe nëse mungesa e një kërkese të tillë nënkupton heqjen dorë të një pale nga kjo e drejtë, varet nga specifikat e ligjit dhe rrethanat e veçanta të një rasti; dhe (ii) në parim, palët kanë të drejtë në një seancë dëgjimore në të paktën një nivel të juridiksionit, përpos nëse "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore", e të cilat bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim ndërlidhen me raste në të cilat shqyrtohen "çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike".

85. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tyre nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtojë me nismën e tij domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore; (ii) parashtruesve të kërkesës iu është mohuar e drejta e seancës dëgjimore në të dy nivelet e DHPGJS-së; (iii) Kolegji i Apelit, nuk kishte trajtuar "çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike" dhe rrjedhimisht nuk "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore"; (iv) Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar çështje "fakti dhe ligji" për më tepër që, kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar në dëm të parashtruesve të kërkesës; dhe (v) Kolegji i Apelit, nuk kishte arsyetuar "heqjen dorë nga seanca gojore". Duke marrë parasysh këto rrethana dhe arsyetimet e tjera të dhëna në këtë Aktgjykim, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht

Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore.

86. Gjykata gjithashtu theksoi se (i) bazuar në ligjin e aplikueshëm për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për vlerësimin e vendimeve të Kolegjit të Specializuar dhe rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka mundësinë e korrigjimit të mungesës së seancës dëgjimore në nivelin e gjykatës më të ulët, përkatësisht, Kolegjit të Specializuar; dhe (ii) nuk është e nevojshme të trajtohen pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës sepse të njëjtat duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit në përputhshmëri me konstatimet e këtij Aktgjykimi; dhe (iii) konstatimi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret ndërlidhet vetëm me garancitë procedurale për një seancë dëgjimore dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet, si dhe nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

87. Gjykata po ashtu konstaton se kërkesa nr. KI178/19 e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës Jakup Abaz Agaj duhet të refuzohet e papranueshme si qartazi e pabazuar siç specifikohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, për shkak se nuk ka ofruar ndonjë provë që do ta lironte atë nga obligimi për mos respektim të afatit ligjor për paraqitje të ankesës në DHPGJS.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 27 janar 2021, me shumicë votash

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se për kërkesat nr. KI160/19, KI161/19, KI162/19, KI164/19, KI165/19, KI166/19, KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19, KI171/19, KI172/19, KI173/19, ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme;

IV. TË KTHEJË çështjen në rigjykim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi;

V. TË URDHËROJË Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës deri më 26 korrik 2021;

VI. TË DEKLAROJË të papranueshme kërkesën me nr. KI178/19 të dorëzuar nga parashtruesi nga Jakup Abaz Agaj;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi

KI181/19, KI182/19 dhe KI183/19, Parashtrues të kërkesës: Fllanza Naka, Fatmire Lima dhe Leman Masar Zhubi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019

KI181/19, KI182/19, KI183/19 Aktgjykim i miratuar më 27 janar 2021, publikuar më 15 shkurt 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për t'u dëgjuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm*

Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesit e kërkesës u ankuan në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër vendimit të AKP-së përkatësisht për shkak të mos përfshirjes së tyre në listën përfundimtare të punëtorëve të NSH "Agimi" Gjakovë. Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme vendosi që parashtruesit e kërkesës të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e 20% nga privatizimi i NSH "Agimi" Gjakovë. Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme, pas ankesës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pa mbajtur seancë dëgjimore, ndryshoi vendimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme dhe refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit e kërkesës të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e 20% nga privatizimi i NSH "Agimi" Gjakovë. Parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar, mes tjerash, shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), për shkak të mos mbajtjes së seancës dëgjimore.

Gjykata vlerësoi pretendimet e parashtruesve te kërkesës, përkitazi me mungesën e seancës dëgjimore në rrethanat e rastit të tyre, si një ndër garancitë e përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenit 6 të KEDNJ-së, duke mbështetur këtë vlerësim në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ).

Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht ka shtjelluar parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika e saj gjyqësore dhe ajo e GJEDNJ-së, përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore, duke i sqaruar rrethanat në të cilat një e tillë është e domosdoshme, bazuar mes tjerash, në Aktgjykimin e Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë. Gjykata ka sqaruar, mes tjerash, se (i) mungesa e kërkesës së një pale për seancë dëgjimore jo detyrimisht nënkupton heqjen dorë nga një e drejtë të tillë dhe nëse mungesa e një kërkese të tillë nënkupton heqjen dorë të një

pale nga kjo e drejtë, varet nga specifikat e ligjit dhe rrethanat e veçanta të një rasti; dhe (ii) në parim, palët kanë të drejtë në një seancë dëgjimore në të paktën një nivel të juridiksionit, përpos nëse "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore", e të cilat bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim ndërlidhen me raste në të cilat shqyrtohen "çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike".

Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tyre nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtojë me nismën e tij domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore; (ii) parashtruesve të kërkesës iu është mohuar e drejta e seancës dëgjimore në të dy nivelet e DHPGJS-së; (iii) Kolegji i Apelit, nuk kishte trajtuar "çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike" dhe rrjedhimisht nuk "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore"; (iv) Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar çështje "fakti dhe ligji" për më tepër që, kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar në dëm të parashtruesve të kërkesës; dhe (v) Kolegji i Apelit, nuk kishte arsyetuar "heqjen dorë nga seanca gojore". Duke marrë parasysh këto rrethana dhe arsyetimet e tjera të dhëna në këtë Aktgjykim, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore.

Gjykata gjithashtu theksoi se (i) bazuar në ligjin e aplikueshëm për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për vlerësimin e vendimeve të Kolegjit të Specializuar dhe rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka mundësinë e korrigjimit të mungesës së seancës dëgjimore në nivelin e gjykatës më të ulët, përkatësisht, Kolegjit të Specializuar; dhe (ii) nuk është e nevojshme të trajtohen pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës sepse të njëjtat duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit në përputhshmëri me konstatimet e këtij Aktgjykimi; dhe (iii) konstatimi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret ndërlidhet vetëm me garancitë procedurale për një seancë dëgjimore dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet, si dhe nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

AKTGJYKIM

në

rastet nr. KI181/19, KI182/19 dhe KI183/19

Parashtrues

Fllanza Naka, Fatmire Lima dhe Leman Masar Zhubi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Fllanza Naka (KI181/19), Fatmire Lima (KI182/19) dhe Leman Masar Zhubi (KI183/19) nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesve të kërkesave u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit],

31 [E Drejta për Gjykim të drejtë dhe të Paanshëm], dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: kushtetuta), nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesit e kërkesës, përmes postës, dorëzuan kërkesat në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) si në vijim: (i) parashtruesi i kërkesës Fllanza Naka (KI181/19) më 3 tetor 2019, (ii) parashtruesi i kërkesës Fatmire Lima (KI182/19) më 3 tetor 2019, dhe (iii) parashtruesi i kërkesës Leman Masar Zhubi (KI183/19) më 5 tetor 2019.

6. Më 16 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës në pajtim me rregullin 40.1 të Rregullores së punës caktoi Gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.

7. Më 16 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës në pajtim me rregullin 40.1 të Rregullores së punës urdhëroi bashkimin e kërkesave nr. KI181/19, KI182/19 dhe KI183/19.

8. Më 20 janar 2020, parashtruesit e kërkesave u njoftuan për regjistrim dhe bashkim të kërkesave dhe një kopje e kërkesave iu dërgua Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme.

9. Më 27 janar 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

10. Në të njëjtën ditë, Gjykata me shumicë konstatoi se (i) kërkesa është e pranueshme; dhe me shumicë konstatoi se (ii) Aktgjykimi [AC-I-13-

0181-A0008] i 29 gushtit 2019 i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se Ndërmarrja Shoqërore NSH "Agimi" Gjakovë është privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) dhe kontrata e shitjes me ofertuesin ishte aprovuar më 15 shtator 2010. Në të njëjtën datë, përmes shkresës [nr.1065], parashtruesit e kërkesës ishin njoftuar se "*pasoja shitjes së aseteve kryesore është përfundimi i punësimit tuaj*" dhe se i njëjti "*përfundon menjëherë*". Të gjithë parashtruesit e kërkesës ishin punëtorë të ndërmarrjes përkatëse në intervale të caktuara kohore.

12. Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime ishte publikuar më 22 dhjetor 2011 dhe data e fundit për dorëzimin e ankesave në AKP kundër Listës Përfundimtare ishte 14 janar 2012.

13. Më 13 dhjetor 2011, AKP-ja refuzoi të pabazuara ankesat e parashtruesve lidhur me mos përfshirjen e emrave të tyre në listën e përkohshme të punëtorëve me të drejtën e përfitimit të një pjese prej 20 % të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Agimi" Gjakovë. Parashtruesit u udhëzuan për të drejtën e ankimit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme brenda njëzet (20) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të AKP-së.

14. Parashtruesit e kërkesave u ankuan në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër vendimit të AKP-së përkatësisht për shkak të mos përfshirjes së tyre në listën përfundimtare të punëtorëve të NSH "Agimi" Gjakovë. Në parim, të gjithë kishin pretenduar se nuk ishin trajtuar në mënyrë të barabartë me punëtorët e tjerë që ishin përfshirë ne Listën Përfundimtare dhe rrjedhimisht ishin diskriminuar.

15. Më 4 shtator 2013, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme me Aktgjykimin (SCEL-11-0075) për parashtruesit e kërkesave KI181/19 (Fllanza Naka), KI182/19 (Fatmire Lima) dhe KI183/19 (Leman Masar Zhubi) vendosi që të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e 20% nga privatizimi i NSH "Agimi" Gjakovë.

16. Lidhur me diskriminim të parashtruesve të kërkesave, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme sqaroi: (i) se gjatë viteve të 90-ta

atyre u ishte ndërprerë marrëdhënia e punës dhe janë larguar nga puna duke u zëvendësuar me punëtorë serb çka është "ngjarje e ditur botërisht" dhe se rrjedhimisht janë diskriminuar; dhe (ii) parashtruesit e kërkesës do t'i kishin plotësuar kushtet në kuptim të nenit 10.4 të Rregullores 2003/13, po të mos ishin subjekt i diskriminimit, ngase të njëjtëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës gjatë viteve të 90-ta. Kolegji i Specializuar po ashtu vlerësoi se AKP-ja si palë e paditur ka obligim në kuptim të nenit 8 të ligjit mbi diskriminim 2004/3, që përcakton: *"[...] se kur personat të cilët konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre paraqesin fakte para Gjykatës nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë barra e provës bie mbi palën e paditur e cila duhet të dëshmoj se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, andaj pas gjithë këtyre Gjykata erdhi në përfundim se ankesat e ankuesve të cekur më lart janë të vlefshme dhe urdhërohen që emrat e tyre të futen në Listën Përfundimtare të punëtorëve."*

17. AKP-ja paraqiti ankesë kundër aktgjykimi të lartpërmendur në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme duke pretenduar se Aktgjykimi i ankimuar është jokonsistent i pa argumentuar në bazë të ligjit, nuk përmban fakte qenësore dhe në mënyrë arbitrare e interpreton ligjin. Sipas AKP-se asnjë ankues i cili me aktgjykimin e atakuar është përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për marrjen e një pjese të ardhurave nga privatizimi i NSH "Agimi" nuk ka prezantuar fakte relevante në bazë të cilave kishte për ta vërtetuar faktin e trajtimit të pabarabartë dhe arsyetimin për diskriminim direkt apo të tërthortë në pajtim me nenin 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit.

18. Parashtruesit e kërkesës paraqitën përgjigje ndaj ankesës së AKP-së duke pohuar se tërë dokumentacioni personal ka qenë në disponim të zyrtarëve NSH "Agimi" Gjakovë. Parashtruesit nuk kanë kërkuar mbajtje të seancës dëgjimore.

19. Më 29 gusht 2019, Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme me Aktgjykim AC-I-13-0181-A0008 e pranoi të bazuar ankesën e AKP-së lidhur me parashtruesit e kërkesave dhe urdhëroi që të njëjtit të hiqen nga lista e përfituesve të 20% nga procesit i privatizimit të NSH "Agimi" Gjakovë. Për sa i përket pretendimeve për diskriminim në baza etnike, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme shtoi se nuk pajtohet me konstatimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme për diskriminim të parashtruesve të kërkesave, sepse në pajtim me praktikën e Dhomës së Posaçme, ata janë të "nacionalitetit shqiptar" dhe nuk kanë mundur të kenë qenë të diskriminuar, në baza etnike,

pas periudhës së qershorit të vitit 1999. Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konkludoi se qasja e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme lidhur me çështjen e interpretimit të diskriminimit të parashtruesve të kërkesës nuk është e saktë dhe e bazuar në ligj, dhe si e tillë, është *"në kundërshtim me të drejtën precedentale"*.

20. Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme duke u bazuar në nenin 69.1 të Shtojcës së Ligjit nr.06/086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, vendosi "*që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës"* dhe vendosi si në vijim:

(xv) Për parashtruesin Fllanza Naka (KI181/19) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka ofruar dëshmi për diskriminim, se ajo kishte themeluar marrëdhënie pune të re, dhe se nuk plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH "Agimi" siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se rrjedhimisht nuk i njihet e drejta për përfshirje në listën përfundimtare për përfitimin e 20% nga shtija e NSH "Agimi".

(xvi) Për parashtruesen Fatmire Lima, (KI182/19) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se ajo nuk është diskriminuar, ka themeluar marrëdhënie pune të re në ndërmarrje tjetër, nuk ka ofruar "asnjë provë" për ta provuar faktin se ka vazhduar në NSH "Agimi" para ose pas qershorit 1999 apo se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

(xvii) Për parashtruesin Leman Masar Zhubi (KI183/19) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka ofruar dëshmi për diskriminim, nuk ka ofruar "asnjë provë" se ka themeluar marrëdhënie pune në NSH "Agimi", se ai nuk plotëson kushtin e të qenit në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH "Agimi" siç parashikon neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se rrjedhimisht nuk i njihet e drejta për përfshirje në listën përfundimtare për përfitimin e 20% nga shtija e NSH "Agimi".

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

3. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
4. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

LIGJI Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 10
Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet

[...]

11. Në rastet kur kolegji i apelit pranon dhe merr përsipër vendosjen mbi një apel, rregullat në vijim respektohen fuqimisht:
11.1. kolegji i apelit nuk mund të ndryshojë, anulojë, rikthejë apo përndryshe të ndërrojë, në çfarëdo mënyrë, gjetjet faktike të bëra nga një gjykatë, kolegj i specializuar, nën-kolegj apo gjyqtar i vetëm, përveç nëse kolegji i apelit përcakton që ajo gjetje faktike është qartësisht e gabueshme. Gjetja faktike nuk vlerësohet të jetë qartësisht e gabueshme nëse ajo gjetje faktike mbështetet me

interpretim të arsyeshëm të dosjes së procedurave gjyqësore dhe provave të parashtruara gjatë atyre procedurave; si dhe 11.2. kolegji i apelit bën shqyrtim, prej fillimit, të secilës çështje që ngrihet nga apeluesi apo pala kundërshtare në parashtresat e tij/saj me shkrim.
[...]

Shtojca e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Rregullorja e Punës e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 36
Rregullat e përgjithshme mbi provat

[...]
3. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Neni 68
Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime

1. Përveç nëse nuk përcaktohet saktësisht me këtë nen, procedura për lëndët që bazohen në ankesat që bien nën paragrafin 1.6. të nenit 4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme do të ndjek rregullat e tjera procedurale të përshkruara në këtë Shtojcë e që Dhoma e Posaçme i zbaton mutatis mutandis nëse i vlerëson si të domosdoshme dhe në interes të drejtësisë.
2. Pas pranimit të listës së të punësuarve me të drejta legjitime në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo në bazë të çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas datës së shpalljes, duke kërkuar përfshirjen në një listë të tillë dhe/apo duke sfiduar përfshirjen e një apo më shumë personave tjerë në një listë të tillë. Personi i cili parashtron një kërkesë apo kundërshtim të tillë, do të përfshijë aty në deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështesin kërkesën apo kundërshtimin e tillë; ai person ka

barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në kërkesë dhe/apo në kundërshtim.
[...]
6. Agjencia shpallë listën e saj përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime në mbështetje të paragrafit 5. të këtij neni e në përputhje me nenin 10.6. të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, ose në pajtim me çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas ditës së shpalljes për të kundërshtuar në listë të tillë dhe/apo në lidhje me shpërndarjen e fondeve të mbledhura nga Agjencia për personat e identifikuar në atë listë. Ankuesi(t) që parashtrojnë një ankesë të tillë përfshijnë një deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështetin ankesën e tillë; personat që ankohen kanë barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në ankesë.
[...]
11. Kolegji gjegjës i Specializuar, me nismë të vet apo në bazë të një kërkese me shkrim nga ankuesi(t) apo Agjencia, mund të vendos për mbajtjen e një apo më shumë seancave gojore lidhur me çështjen. Nëse mbahet një seance gojore, atëherë Kolegji Specializuar do të udhëzojë Regjistër mbajtësin që, së paku pesë (5) ditë më herët para seancës gojore, t"i dorëzojë palëve një njoftim me shkrim për kohën dhe ditën e seancës së tillë.
[...]
14. Kolegji i Apelit zgjidhë të gjitha apelet e tilla urgjentisht.

Neni 64
Procedurat e ankesës me gojë

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkese për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.
[...]

Neni 65
Paraqitja e provave të reja

Në rrethana të jashtëzakonshme dhe për arsye që dëshmohen mirë, Kolegji i Apelit mund t"i lejoj një pale paraqitjen e provave të reja që nuk kanë qenë në dispozicion të palës gjatë procedurës së shkallës së parë për vlerësimin e provave. Kërkesa me shkrim për një leje të tillë duhet së pari t"i dorëzohet Kolegjit të Apelit dhe duhet t"i dorëzohet palëve tjera jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së seancës kur propozohet paraqitja e këtyre provave. Kolegji i Apelit mund të autorizojë paraqitjen e provave të reja nëse vlerëson se në këtë mënyrë drejtësia do të vihet në vend.

Rregullore Nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në Pronësi Shoqërore

Neni 10
Të Drejtat e të punësuarve

[...]
10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilit pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qënë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.
[...]

Rregullore Nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores Nr. 2003/ 13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore

Neni 1
Ndryshimet

Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje,
[...]
B. Nenet 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 ndryshohen si vijon:
[...]

10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit apo të fillimit të procedurës së likuidimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vite. Kjo kërkesë nuk i përjashton punëtorët nga paraqitja e ankesës në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6., të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar po të mos kishin qenë të diskriminuar.
[...]

Ligji Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 69
Procedurat e ankesës me gojë

2. *Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkese për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.*
[...]

Ligji Nr. 2004/3 kundër Diskriminimit

Neni 8
Barra e provave

8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.
8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda te tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

21. Parashtruesit e kërkesave pretendojnë shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

22. Lidhur me pretendimin për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesit e kërkesave pohojnë se Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme është dashur që të mbajë seancë publike duke i ftuar të gjithë ankuesit për t'i paraqitur drejtpërdrejtë dhe në mënyrë transparente pretendimet dhe provat e tyre, sidomos, duke pasur parasysh faktin se Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme për pjesën dërmuese të tyre kishte njohur të drejtën për përfitim nga 20% e shitjes së NSH "Agimi" Gjakovë. Parashtruesit e kërkesave po ashtu pretendojnë se Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme është dashur ta kthej çështjen në rigjykim dhe rivendosje në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme. Sipas parashtruesve të kërkesave defektet e lartpërmendura të procesit gjyqësor në Dhomën e Posaçme kanë rezultuar me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

23. Parashtruesit e kërkesave po ashtu pretendojnë shkelje të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

24. Lidhur me pretendimin për diskriminim, Parashtruesit e kërkesave pretendojnë se diskriminimi konsiston në faktin se punëtorët me të drejta legjitime janë larguar lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta për përfitim nga shitja e NSH "Agimi" Gjakovë dhe jo në baza etnike siç ka arsyetuar Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme.

25. Përfundimisht parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata: (i) t'i deklarojë kërkesat të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; (iii) ta shpall të pavlefshëm Aktgjykimin të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019 dhe të njëjtin ta kthej për rigjykim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
>
> *[...]*

28. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

> *Neni 48*
> *[Saktësimi i kërkesës]*
>
> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*
>
> *Neni 49*
> *[Afatet]*
>
> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".*

29. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesave janë palë të autorizuara, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-

13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

30. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Veç kësaj, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

31. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me privatizimin e ndërmarrjes shoqërore NSH "Agimi" në Gjakovë, dhe të drejtat e punëtorëve përkatës për t'iu njohur statusi i punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga ky privatizim, siç është përcaktuar në nenin 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, dhe paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores 2003/13 e ndryshuar me Rregulloren nr. 2004/45. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se ndërmarrja e lartcekur shoqërore ishte privatizuar më 15 shtator 2010, datë kjo në të cilën gjithashtu parashtruesit e kërkesës përmes shkresave individuale ishin njoftuar se "*pasoja shitjes së aseteve kryesore është përfundimi i punësimit tuaj*" dhe se i njëjti "*përfundon menjëherë*". Parashtruesit e kërkesës më pas kishin kontestuar mospërfshirjen e tyre në Listën e Përkohshme të AKP-së për punëtorët me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi". Këto ankesa ishin refuzuar. Në vijim, parashtruesit e kërkesës kishin iniciuar padi në Kolegjin e Specializuar, duke kontestuar Vendimin e AKP-së, edhe përkitazi me vërtetimin e fakteve edhe interpretimin e ligjit. Të njëjtit kishin pretenduar se ishin diskriminuar dhe të gjithë kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore para Kolegjit të Specializuar. Ky i fundit, kishte refuzuar kërkesën për seancë dëgjimore me arsyetimin se *"faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaft të qarta"*, dhe u kishte dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës.

32. Pas nxjerrjes së këtij Aktgjykimi, ankesë në Kolegj të Apelit kishte paraqitur AKP-ja. Në gusht të vitit 2019, Kolegji i Apelit, kishte nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar, përmes të cilit kishte miratuar ankesën e AKP-së duke e ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe për pasojë, duke hequr "nga lista e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të NSH-së "Agimi" Gjakovë", të gjithë parashtruesit e kërkesës. Kolegji i Apelit, kishte theksuar se kishte vendosur të "heq dorë nga pjesa e seancës gojore", duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 (Procedura e ankesës me gojë) të Ligjit nr. 06/L-086 për DHPGJS-në. Ndërsa, përkitazi me meritat e çështjes, (i) kishte konstatuar se provat e paraqitura nga palët përkatëse nuk dëshmojnë se të njëjtit i plotësojnë kushtet ligjore të përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13 për t'iu njohur të drejtat përkatëse; dhe (ii) kishte theksuar se interpretimi i diskriminimit nga Kolegji i Specializuar është në kundërshtim me "të drejtën precedentale" të DHPGJS-së. Këto konstatime të Kolegjit të Apelit, parashtruesit e kërkesës i kontestojnë para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Përkitazi me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës, siç është sqaruar më lart, pretendojnë se Kolegji i Apelit ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, (i) pa një seancë dëgjimore; (ii) pa arsyetim të mjaftueshëm; (iii) në interpretim arbitrar të ligjit; dhe (iv) në shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

33. Këto pretendime, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

34. Gjykata, në këtë aspekt, do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit. Për këtë qëllim, në vijim, Gjykata (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore siç është e garantuar përmes neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së; dhe më pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(ii) Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore

35. Karakteri publik i procedurave para organeve gjyqësore të referuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, mbron palët ndërgjyqëse nga administrimi i drejtësisë në fshehtësi, në mungesë të një shqyrtimi publik. Publiciteti i procedurave gjyqësore është gjithashtu një nga mekanizmat kryesor përmes të cilës ruhet besimi në drejtësi. Një parim i tillë, për më tepër, kontribuon në arritjen e qëllimeve të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike të mishëruara në Kushtetutë dhe KEDNJ (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 381 deri 404 dhe referencat e përdoruara aty).

36. Në parim, palët ndërgjyqëse kanë të drejtë për një seancë dëgjimore publike, por një detyrim i tillë nuk është absolut. Për aq sa është relevante për rrethanat e tanishme, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka zhvilluar parimet kryesore që kanë të bëjnë me (i) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë; (ii) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë dhe të tretë; (iii) parimet në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme; dhe (iv) nëse mungesa e dëgjimit në shkallën e parë mund të korrigjohet përmes një seance dëgjimore në një shkallë më të lartë dhe kriteret përkatëse për të bërë këtë vlerësim. Sidoqoftë, në të gjitha rrethanat, mungesa e një seancë dëgjimore duhet të jetë e arsyetuar nga gjykata përkatëse.

37. Për sa i përket çështjes së parë, përkatësisht detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë, GJEDNJ ka theksuar se në procedurat para një gjykate të shkallës së parë dhe të vetme, e drejta për një seancë dëgjimore është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, Fredin kundër Suedisë (nr. 2), Aktgjykim i 23 shkurtit 1994, paragrafët 21-22; Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2), Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 46; Göç kundër Turqisë, Aktgjykim i 11 korrikut 2002, paragrafi 47; dhe Selmani dhe të tjerët kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Aktgjykim i 9 shkurtit 2017, paragrafët 37-39). Përjashtim nga ky parim i përgjithshëm, përbëjnë rastet në të cilat "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore" në shkallën e parë dhe të vetme (shih, në këtë aspekt, rastet e GJEDNJ-së, Hesse-Anger dhe Anger kundër Gjermanisë, Vendim i

17 majit 2001; Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë, Aktgjykim i 13 marsit 2018, paragrafi 36; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 382 dhe referencat e përdoruara aty). Karakteri i rrethanave të tilla të jashtëzakonshme buron nga natyra e çështjeve që ngërthen një rast, për shembull, rastet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës shumë teknike (shih rastin e GJEDNJ-së, Koottummel kundër Austrisë, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009, paragrafët 19 dhe 20).

38. Për sa i përket çështjes së dytë, përkatësisht detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, Salomonsson kundër Suedisë, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 36). Prandaj, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore. Rrjedhimisht, procedurat lidhur me të cilat është mbajtur një seancë dëgjimore në shkallën e parë dhe lidhur me të cilën, procedurat e shkallës së dytë kanë përfshirë vetëm çështje ligji dhe jo fakti, në parim, janë në përputhshmëri me garancitë procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse një pale nuk i është dhënë mundësia të dëgjohet personalisht në nivel apeli (shih rastin e GJEDNJ-së, Miller kundër Suedisë, Aktgjykim i 8 shkurtit 2005, paragrafi 30; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 383 dhe referencat e përdoruara aty). Më saktësisht, në raste kur para gjykatave me juridiksion apeli shqyrtohen edhe çështje fakti edhe ligji, mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet vetëm përmes "ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme", siç janë definuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Prandaj, përveç nëse "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore", kjo e fundit është e garantuar për palët në të paktën njërin nivel të juridiksionit, bazuar në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 386 dhe referencat e përdoruara aty).

39. Për sa i përket çështjes së tretë, përkatësisht parimeve në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme, Gjykata i referohet Aktgjykimit të 6 nëntorit 2018 të GJEDNJ-së: Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë, në të cilin Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së, vendosi parimet bazuar në të cilat duhet të vlerësohet domosdoshmëria e një seance dëgjimore. Sipas këtij Aktgjykimi, një seancë dëgjimore nuk është e domosdoshme nëse rasti përkatës (i) ngërthen thjeshtë çështje juridike të një natyre të kufizuar (shih rastet e GJEDNJ-së, Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2), cituar më lartë, paragafi 49; dhe Valová, Slezák dhe Slezák kundës Sllovakisë, Aktgjykim i qershorit 2004, paragrafët 65-68) ose nuk ngërthen ndonjë ndërlikueshmëri të veçantë (shih rastin e GJEDNJ-së, Varela Assalino kundër Portugalisë, Vendim i 25 prillit 2002); dhe (ii) ngërthen çështje tepër teknike, të cilat trajtohen më mirë me shkrim sesa përmes argumenteve gojore në një seancë dëgjimore; dhe (iii) nuk ngërthen çështje të besueshmërisë së palëve ose fakteve të kontestuara dhe gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme në bazë të parashtresave të palëve dhe materialeve të tjera me shkrim (shih rastet e GJEDNJ-së, Döry kundër Suedisë, Aktgjykim i 12 nëntorit2002, paragrafi 37; dhe Saccoccia kundër Austrisë, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008, paragrafi 73).

40. Në të kundërtën, bazuar në Aktgjykimin e lartpërmendur, një seancë dëgjimore është e domosdoshme nëse rasti përkatës (i) ngërthen nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë (shih rastet e GJEDNJ-së, Malhous kundër Republikës Çeke, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 60; dhe Fischer kundër Austrisë, Aktgjykim i 26 prillit 1995, paragrafi 44); dhe (ii) kërkon që gjykata përkatëse të fitojë një përshtypje personale për palët përkatëse, dhe t'u lejohet të njëjtëve mundësia të sqarojnë gjendjen personale, personalisht ose përmes përfaqësuesit përkatës. Shembuj të kësaj situate përbëjnë rastet kur gjykata duhet të dëgjojë prova nga palët në lidhje me vuajtjet personale në mënyrë që të përcaktojë nivelin e duhur të kompensimit (shih rastet e GJEDNJ-së, Göç kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 51; dhe Lorenzetti kundër Italisë, Aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafi 33) ose duhet të sigurojë informacion në lidhje me karakterin, sjelljen dhe rrezikshmërinë e një pale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, De Tommaso kundër Italisë, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafi 167).

41. Për sa i përket çështjes së katërt, përkatësisht mundësisë së korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë dhe kritereve respektive, GJEDNJ përmes praktikës së saj

gjyqësore ka përcaktuar se në parim, një korrigjim i tillë varet nga kompetencat e gjykatës më të lartë. Nëse kjo e fundit, ka juridiksion të plotë për të shqyrtuar meritat e rastit përkatës, përfshirë edhe vlerësimin e fakteve, atëherë korrigjimi i mungesës së një seance dëgjimore në shkallë të parë, mund të bëhet në shkallën e dytë (shih rastin e GJEDNJ-së, Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë, cituar më lart, paragrafi 192 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 384 dhe referencat e përdoruara aty).

42. Përfundimisht, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, fakti që palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore nuk do të thotë që të njëjtat kanë hequr dorë nga e drejta për të mbajtur një të tillë (për më shumë, lidhur me heqjen dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore, shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 401 dhe 402 dhe referencat e përdorura aty). Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, një çështje e tillë varet nga karakteristikat e ligjit vendor dhe rrethanat e secilit rast veç e veç (shih rastin e GJEDNJ-së, Göç kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 48; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafi 403 dhe referencat e përdorura aty).

(ii) Aplikimi i parimeve të shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret

43. Gjykata rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së, në parim, garanton mbajtjen e një seance dëgjimore në të paktën njërin nivel të vendimmarrjes. Një e tillë është, në parim, (i) e detyrueshme nëse gjykata e shkallës së parë ka kompetencën e vetme të vendimmarrjes përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit; (ii) jo e detyrueshme në shkallë në dytë nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallë të parë, përkundër faktit që një përcaktim i tillë varet nga karakteristikat e rastit përkatës, për shembull, nëse shkalla e dytë vendos edhe për çështje fakti edhe ligji; dhe (iii) e detyrueshme në shkallë të dytë nëse një e tillë nuk është mbajtur në shkallë të parë, në rastet kur shkalla e dytë ka kompetencë të plotë për të vlerësuar vendimin e shkallës së parë, edhe përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit. Përjashtime nga këto raste, në parim, bëhen vetëm nëse "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore", dhe të cilat GJEDNJ, siç është

sqaruar më lart, përmes praktikës së saj gjyqësore i ka përcaktuar si raste që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës së lartë teknike.

44. Bazuar në parimet e shtjelluara më lart, Gjykata në vijim duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar një seancë dëgjimore në Kolegjin e Apelit, mund të rezultojë në konstatimin se të njëjtit kanë hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga një seancë dëgjimore. Nëse përgjigja në këtë çështje rezulton të jetë negative, atëherë Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore" në të dy shkallët e vendimmarrjes, para Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit, respektivisht. Këtë vlerësim Gjykata do të bëjë duke u bazuar edhe në parimet e vendosura përmes Aktgjykimit të Dhomës së Madhe Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë.

b) Nëse parashtruesit e kërkesës kanë hequr dorë nga e drejta e një seance dëgjimore

45. Gjykata në këtë aspekt, rikujton që përmes ankesave individuale të parashtruara në Kolegjin e Specializuar, të gjithë parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. Kolegji i Specializuar kishte refuzuar mbajtjen e të njëjtës, duke theksuar se bazuar në paragrafin 11 të nenit 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-së, seanca dëgjimore nuk ishte e nevojshme sepse "faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaftë të qarta". Siç, është sqaruar tashmë, Kolegji i Specializuar, bazuar në këto "fakte dhe prova", kishte vendosur se parashtruesit e kërkesës ishin diskriminuar duke vendosur gjithashtu se të njëjtit duhet të përfshihen në Listën Përfundimtare të AKP-së si punëtorë me të drejta legjitime për të përfituar nga njëzet përqindëshi (20%-it) i privatizimit të NSH "Agimi".

46. Në Kolegjin e Apelit ishte ankuar vetëm AKP-ja. Kolegji i Apelit kishte vendosur në favor të AKP-së, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe duke refuzuar ankesat e të gjithë parashtruesve përkitazi me mospërfshirjen në Listën Përfundimtare të AKP-së si rezultat i diskriminimit. Siç është sqaruar më lart, Kolegji i Apelit kishte vendosur të "heq dorë nga pjesa e seancës gojore", duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 të Ligjit nr. 06/L-086për DHPGJS-në.

47. Megjithatë, siç është sqaruar më lart, fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë bërë kërkesë për një seancë dëgjimore, jo detyrimisht do të

thotë se të njëjtit kanë hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga një kërkesës e tillë, dhe gjithashtu mungesa e kësaj kërkese jo detyrimisht e liron gjykatën përkatëse nga detyrimi për mbajtjen e një seancë të tillë.

48. Më saktësisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në rrethanat e rasteve në të cilat palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seancë dëgjimore, GJEDNJ, mes tjerash, vlerëson nëse mungesa e një kërkesë të tillë, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar të një parashtruesi nga e drejta për një seancë dëgjimore. Megjithatë, mungesa e kërkesës për një seancë dëgjimore, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, asnjëherë nuk është faktori i vetëm që përcakton domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance dëgjimore. Në të gjitha rastet, nëse mungesa e kërkesës për seancë dëgjimore e liron një gjykatë nga detyrimi për mbajtjen e një seancë dëgjimore, varet nga (i) specifikat e ligjit të aplikueshëm; dhe (ii) rrethanat e një rasti (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 401 deri 404 dhe referencat e përdoruara aty). Në vijim, Gjykata do të vlerësojë këto dy çështje.

49. Së pari, përkitazi me specifikat e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht Ligjit dhe Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Gjykata rikujton se bazuar në nenin 64 (Procedurat e ankesës me gojë) të të njëjtit ligj, "Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse", në bazë të nismës së tij apo edhe kërkesës me shkrim nga një palë. Neni 69 (Procedurat e ankesës me gojë) i Ligjit Nr. 06/L-086 për DHPGJS, ka të njëjtën përmbajtje. Bazuar në këto dispozita rrjedhimisht, mbajtja e një seancë dëgjimore në nivel apeli, jo detyrimisht varet nga kërkesa e palës. Është gjithashtu detyrë e Kolegjit përkatës, që bazuar në nismën e tij, të vlerësojë nëse rrethanat e një rasti kërkojnë mbajtjen e një seance dëgjimore. Për më tepër, bazuar në nenin 60 (Përmbajtja e ankesës) dhe nenin 65 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të vlerësojë edhe çështjet e ligjit edhe të faktit, dhe për pasojë, është e pajisur me kompetencë të plotë për të vlerësuar mënyrën se si ka vlerësuar faktet instanca më e ulët, përkatësisht Kolegji i Specializuar. Në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Apelit ka vlerësuar faktet dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar edhe përkitazi me vlerësimin e fakteve edhe interpretimin e ligjit, në dëm të parashtruesve të kërkesës. Në rrethana të tilla, duke marrë parasysh dispozitat ligjore, Gjykata nuk mund të konstatojë se mungesa e një seance dëgjimore në Kolegj të Apelit është e justifikuar vetëm si rezultat i mungesës së një kërkese nga palët në procedurë,

posaçërisht marrë parasysh faktin që parashtruesit e kërkesës nuk janë ankuar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, i cili ishte në favor të tyre. Siç është sqaruar më lartë, bazuar në nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në është detyrim i Kolegjit të Apelit që edhe me nismën e tij të vlerësojë nëse mbajtja e një seancë dëgjimore është e detyrueshme, dhe nëse jo, të arsyetoj mos-mbajtjen e së njëjtës (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 61).

50. Së dyti, përkitazi me rrethanat e një rasti, Gjykata rikujton që praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, thekson se mungesa e një kërkese për një seancë dëgjimore, dhe vlerësimi nëse ky fakt mund të rezultojë në konstatimin se pala përkatëse në mënyrë të nënkuptuar ka hequr dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore, duhet të vlerësohet në tërësinë e specifikave të një procedure, dhe jo si argument i vetëm, për të konstatuar nëse mungesa e një seance dëgjimore ka rezultuar ose jo në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

51. Më specifikisht, në rastet kur një palë përkatëse nuk ka kërkuar seancë dëgjimore, GJEDNJ ka vlerësuar nëse mungesa e një kërkese të tillë mund të konsiderohet sikur heqje dorë e nënkuptuar nga një seancë dëgjimore, gjithmonë duke pasur parasysh ligjin e zbatueshëm dhe rrethanat e rastit. Për shembull (i) në rastin Miller kundër Suedisë (Aktgjykim i 6 majit 2005), në të cilin, parashtruesja përkatëse nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të apelit, por e njëjta kishte kërkuar mbajtjen e një seancë dëgjimore në nivel të shkallës së parë, kishte rezultuar në konstatimin e GJEDNJ-së që kërkesa për seancë dëgjimore ishte bërë në fazën "më të duhur e procedurave" dhe për pasojë, GJEDNJ kishte theksuar se nuk mund të konstatohet se pala ka hequr dorë nga kërkesa për seancë dëgjimore në mënyrë të nënkuptuar. Për më tepër, në kombinim me konstatimin se në nivel apeli ishin shqyrtuar edhe çështje fakti edhe ligji, dhe për pasojë natyra e çështjeve në shqyrtim nuk ishte ekskluzivisht ligjore e as teknike, GJEDNJ, konstatoi se nuk ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore, duke konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së: Miller kundër Suedisë, cituar më lart, paragrafët 28-37); gjithashtu (ii) në rastin Salomonsson kundër Zvicrës (Aktgjykim i 12 shkurtit 2003), në të cilin, parashtruesi përkatës nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore në asnjërën nga instancat, GJEDNJ edhe pse konstatoi se parashtruesi përkatës mund të konsiderohet se ka hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga e drejta në një seancë dëgjimore (shih paragrafin 35 të rastit Salomonsson kundër Zvicrës),

megjithatë konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore, sepse konkludoi që në rrethanat e rastit konkret, nuk ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore, posaçërisht marrë parasysh faktin që niveli i apelit shqyrtoi edhe çështje fakti dhe jo vetëm ligji (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 63 dhe rastin e GJEDNJ-së *Salomonsson kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafët 36-40).

52. Në anën tjetër, në rastin, *Goç kundër Turqisë*, GJEDNJ gjithashtu konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, duke refuzuar pretendimet e Qeverisë Turke se (i) rasti ishte i thjeshtë dhe se mund të trajtohej me shpejtësi vetëm në bazë të shkresave të lëndës, veçanërisht për shkak se parashtruesi përkatës përmes ankesës nuk kërkoi sjelljen e ndonjë prove të re; dhe se (ii) parashtruesi përkatës nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore (për faktet e rastit, shih paragrafët 11 deri 26 të rastit të GJEDNJ-së Goç kundër Turqisë). Në shqyrtimin e rastit përkatës, dhe pas vlerësimit nëse në rrethanat e tij ekzistonte ndonjë rrethanë e jashtëzakonshme që do të justifikonte mungesën e një seance dëgjimore, GJEDNJ konstatoi shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, duke theksuar, mes tjerash, se (i) përkundër faktit që parashtruesi përkatës nuk kishte bërë kërkesë për një seancë dëgjimore, nga rrethanat e rastit nuk rezulton se një kërkesë e tillë do të kishte ndonjë perspektivë suksesi; për më tepër që (ii) nuk mund të konsiderohet se parashtruesi përkatës ka hequr dorë nga e drejta e tij për një seancë dëgjimore duke mos kërkuar një të tillë para gjykatës së apelit pasi që kjo e fundit nuk kishte juridiksion të plotë për të përcaktuar shumën e kompensimit; (iii) parashtruesit përkatës nuk i ishte dhënë mundësia të dëgjohet as para shkallës më të ulët dhe e cila kishte kompetencë edhe për vlerësimin e fakteve edhe të ligjit; dhe (iv) çështja thelbësore, në rrethanat e këtij rasti, ishte nëse parashtruesit përkatës duhet t'i ofrohej një seancë dëgjimore para një gjykate e cila ishte përgjegjëse për vërtetimin e fakteve të rastit (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 64 dhe për arsyetimin e rastit, shih paragrafët 43 deri 52 të rastit Goç kundër Turqisë).

53. Për dallim, në raste tjera, GJEDNJ ka konstatuar se fakti që një parashtrues nuk ka kërkuar një seancë dëgjimore mund të

konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar nga kjo e drejtë, mirëpo gjithmonë së bashku me vlerësimin nëse, në rrethanat e një rasti, ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të e justifikonin mungesën e një seancë dëgjimore. Për shembull, në rastet Schuler-Zgraggen kundër Zvicrës (Aktgjykim i 24 qershorit 1993) dhe Dory kundër Suedisë (Aktgjykim i 12 shkurtit 2003), në të cilat, parashtruesit përkatës nuk kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore, GJEDNJ kishte vlerësuar se të njëjtit kishin hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga e drejtat në një seancë dëgjimore. Megjithatë, këtë konstatim GJEDNJ e kishte arritur, vetëm në ndërlidhje me konstatimin se rrethanat e rastit përkatës ishin të "natyrës teknike", dhe rrjedhimisht ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që e justifikojnë mungesës e një seance dëgjimore, duke mos konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, Miller kundër Suedisë, cituar më lartë, paragrafët 28-37; Dory kundër Suedisë, cituar më lartë, paragrafët 36-45). Ngjashëm, GJEDNJ kishte vepruar edhe në rastin Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës (Aktgjykimi i 19 prillit 2007), në të cilin nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 65 dhe për arsyetimet, përkitazi me seancën dëgjimore, shih paragrafët 73 deri 75 në rastin Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës).

54. Gjykata gjithashtu bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, thekson se fakti që para gjykatave përkatëse ka mbizotëruar praktikë e zhvillimit të procedurës më shkrim dhe pa seanca dëgjimore, nuk është marrë parasysh nga GJEDNJ si fakt i vetëm bazuar në të cilin mund të anashkalohet një seancë dëgjimore, pa marrë parasysh rrethanat specifike të një rasti. Për shembull, në rastin Madamus kundër Gjermanisë (Aktgjykim i 9 qershorit 2016), kishte shqyrtuar edhe pretendime bazuar në të cilat, ligji i aplikueshëm parashihte mbajtjen e seancave dëgjimore si përjashtim dhe jo si rregull, për më tepër që bazuar në praktikën përkatëse, gjykata vendimi i së cilës kontestohej para GJEDNJ-së, asnjëherë nuk kishte mbajtur një seancë dëgjimore. Përkundër këtij fakti, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, pasi vlerësoi dhe konstatoi që në rrethanat e këtij rasti nuk ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e mbajtjes së një seancë dëgjimore (shih paragrafët 25 deri më 33 të rastit Madamus kundër Gjermanisë).

55. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, (i) parashtruesve të kërkesës nuk u është dhënë mundësi të dëgjohen para Kolegjit të

Specializuar, me kompetencë për vlerësimin e fakteve dhe të ligjit, përkundër kërkesës së tyre; (ii) parashtruesit e kërkesës nuk ishin ankuar në Kolegjit e Apelit sepse vendimi i Kolegjit të Specializuar ishte në favor të tyre; (iii) procedura në Kolegjin i Apelit ishte iniciuar përmes ankesës së AKP-së; (iv) Kolegji i Apelit, kishte "hequr dorë nga seanca", duke u referuar në nenin 69 të Ligjit 06/L-086 për DHPGJS-në, nen ky identik me nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, të cilët thjeshtë përcaktojnë se "Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse"; dhe (v) Kolegji i Apelit, kishte shqyrtuar të gjitha faktet e rastit, duke përshirë ankesat e parashtruesve të dorëzuara në shkallë të parë, dhe duke theksuar se nuk pajtohet as me vlerësimin e fakteve dhe as me interpretimin e ligjit nga gjykata e shkallës më të ulët, kishte ndryshuar në tërësi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, duke i hequr të gjithë parashtruesit e kërkesës nga Lista e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar nga njëzet përqindëshi (20%-it) i privatizimit të ndërmarrjes NSH "Agimi".

56. Në rrethana të tilla, Gjykata nuk mund të konstatojë se mungesa e kërkesës së parashtruesve të kërkesës për mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar e tyre nga e drejta për një seancë dëgjimore. Gjykata rikujton se në të gjitha rastet në të cilat GJEDNJ kishte arritur në një konstatim i tillë, e kishte bërë në ndërlidhje me faktin se rrethanat e rasteve ndërlidheshin me çështje të natyrës ekskluzivisht ligjore ose të natyrës teknike, dhe rrjedhimisht "ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seancë dëgjimore". Për pasojë dhe në vijim, Gjykata duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, "ekzistojnë rrethanat të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seance dëgjimore", përkatësisht nëse natyra e çështjeve në vlerësim para Kolegjit të Apelit, mund të klasifikohet si "ekskluzivisht ligjore apo e natyrës së lartë teknike" (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 68).

b) Nëse në rrethanat e rastit konkret ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e seancës dëgjimore

57. Gjykata rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, palët kanë të drejtë në seancë dëgjimore në të paktën njërën instancë.

Kjo instancë, është kryesisht instanca e parë, dhe ajo e cila e ka juridiksionin për të vendosur edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji. Në këtë kontekst, përkitazi me detyrimin për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë. Në parim, nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallën e parë, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore. Në parim, përjashtim nga e drejta për një seancë dëgjimore, janë vetëm ato raste, në të cilat përcaktohet se ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore. Këto rrethana, siç është sqaruar më lart, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së i ka klasifikuar si raste të cilat ndërlidhen me çështje ekskluzivisht ligjore apo të natyrës së lartë teknike (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 69).

58. Për shembull, çështjet që ndërlidhen me sigurime sociale, GJEDNJ, kryesisht, i ka klasifikuar si çështje të natyrës teknike, në të cilat, jo detyrimisht është e domosdoshme një seancë dëgjimore. Sigurisht, nga ky rregull ka përjashtime. Në çdo rast, shqyrtohen rrethanat konkrete të një rasti. Për shembull, GJEDNJ nuk kishte konstatuar shkelje në rastet Schuler-Zgraggen kundër Zvicrës dhe Dory kundër Suedisë, por kishte konstatuar shkelje në rastin Miller kundër Suedisë dhe Salomonsson kundër Zvicrës, edhe pse të gjitha ndërlidheshin me çështje të sigurimeve sociale.

59. Në mënyrë të ngjashme, GJEDNJ vepron edhe në ato raste në të cilat çështjet para Gjykatës përkatëse janë ekskluzivisht ligjore, dhe nuk përfshijnë fakte kontestuese. Për shembull, në rastin Saccoccia kundër Austrisë (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore, pasi konstatoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin çështje fakti, por vetëm çështje të limituar të natyrës ligjore (Saccoccia kundër Austrisë, cituar më lartë, paragrafi 78), ndërsa në rastin Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2) (Aktgjykim i 19 shkurtit 1998), gjithashtu GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore, pasi konstatoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi

përkatës nuk ngërthenin as çështje ligji e as fakti (shih rastin e GJEDNJ-së, Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2), cituar më lartë, paragrafi 49).

60. Përkundrazi në raste tjera e në të cilat, GJEDNJ përcaktoi se çështjet para gjykatave përkatëse ngërthenin edhe çështje fakti edhe ligji, ajo nuk konstatoi se ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore. Për shembull, në rastet Malhous kundër Republikës Çeke (Aktgjykim i 12 korrikut 2001), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, pasi përcaktoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin vetëm çështje ligji por edhe fakti, përkatësisht vlerësimin nëse autoriteti më i ulët i kishte vlerësuar faktet në mënyrë të drejtë (shih rastin e GJEDNJ-së Malhous kundër Republikës Çeke, cituar më lartë, paragrafi 60). Në të njëjtën mënyrë, në rastin Koottummel kundër Austrisë (Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për mungesë të një seance dëgjimore, sepse konstatoi së çështjet para saj nuk mund të kualifikoheshin si çështje të natyrës ekskluzivisht ligjore ose të natyrës teknike, që do të mund të konsistonin në rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore (shih rastin e GJEDNJ-së, Koottummel kundër Austrisë, cituar më lartë paragrafët 20 dhe 21).

61. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që Kolegji i Apelit, ka juridiksion edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji. Bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 (Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet) të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Ligji për DHPGJS-në) dhe paragrafin 4 të nenit 64 (Procedurat e ankesës me gojë) dhe nenin 65 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, palët, ndër tjerash, kanë mundësinë që të paraqesin ankesat para Kolegjit të Apelit edhe përkitazi me çështjet e ligjit edhe të fakteve, duke përfshirë edhe mundësinë që të paraqiten prova të reja (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 73).

62. Për më tepër, në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar të gjitha faktet e paraqitura përmes ankesës fillestare të parashtruesve të kërkesës në Kolegjin e Specializuar në Kolegjin e Apelit dhe të përgjigjeve përkatëse në ankesë të parashtruesve të kërkesës. Përkundër faktit që Kolegji i Specializuar kishte vlerësuar se

provat "janë të qarta" duke u dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës, Kolegji i Apelit kishte konstatuar të kundërtën bazuar në po të njëjtat prova.

63. Gjykata gjithashtu rikujton që bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 të Ligjit nr. për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit është i kufizuar në ndërrimin e vlerësimit të gjendjes faktike të bërë nga Kolegji i Specializuar, përpos nëse përcakton që gjetjet faktike të gjykatës më të ultë janë "qartësisht të gabueshme", rregull kjo që sipas të njëjtit nen duhet të "respektohet fuqimisht". Një arsyetim i tillë, nuk gjendet në Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit. Ky i fundit, thjesht nuk ishte pajtuar më vlerësimin e provave nga Kolegji i Specializuar, dhe gjithashtu kishte konstatuar se interpretimi të cilin Kolegji i Specializuar ia ka bërë pretendimeve përkitazi me diskriminim, është në kundërshtim me "të drejtën precedentale".

64. Gjykata më tej vëren, se bazuar në nenin 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, në rast të ankesave lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, barra e provës bie mbi parashtruesit e kërkesës përkatëse para Kolegjit të Specializuar. Po ashtu, barra e të provuarit për kundërshtuesin e një kërkesë të tillë, bie mbi kundërshtuesin, përkatësisht AKP-në, në rrethanat e rastit konkret. Para Kolegjit të Apelit, barra e të provuarit gjithashtu bie mbi parashtruesin e ankesës përkatëse. Por, rrethanat e rastit konkret, gjithashtu, në esencë ndërlidhen me pretendime për diskriminimin. Në rast të pretendimeve të tilla, barra e të provuarit, bazuar në nenin 8 (Barra e provave) të Ligjit kundër Diskriminimit, bie mbi palën e paditur, përkatësisht AKP-në, dhe jo parashtruesit e kërkesës (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 76).

65. Në rrethanat e tilla, në të cilat (i) Kolegji i Apelit ka shqyrtuar edhe çështje fakti edhe ligji; (ii) në të cilat përkitazi me faktet, barra e të provuarit se i plotësojnë kriteret e paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13, në parim bie mbi parashtruesit e kërkesës, ndërsa barra e të provuarit lidhur me diskriminimin bie mbi AKP-në; dhe (iii) Kolegji i Apelit interpreton të njëjtat fakte të paraqitura nga palët në mënyrë të ndryshme nga mënyra se si i ka interpretuar Kolegji i Specializuar, duke ndryshuar Aktgjykimin në dëm të palëve, përkundër faktit që një mundësi e tillë bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-033 për DHPGJS-në, i është njohur vetëm përjashtimit, me kushtin që të argumentojë që autoriteti më i ulët, përkatësisht Kolegji i Specializuar, ka bërë interpretim "qartësisht të

gabueshëm", Gjykata vlerëson se është e pakontestueshme që çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk është (i) as çështje ekskluzivisht ligjore; dhe (ii) as e natyrës teknike. Përkundrazi, çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit ngërthente çështje të rëndësishme faktike dhe ligjore. Në një situatë të tillë, rëndësia për palët që t'iu ofrohet një seancë kontradiktore përpara organit që kryen rishikimin gjyqësor nuk duhet të nënvlerësohet. Për pasojë, Gjykata duhet të konstatojë, se në rrethanat e rastit konkret, nuk ekzistojnë rrethana të cilat do e justifikonin mungesën e seancës dëgjimore (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 77).

66. Në mbështetje të këtij konstatimi, Gjykata rikujton që përmes Aktgjykimit të GJEDNJ-së, Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë, specifikisht ishte përcaktuar se një seancë dëgjimore është e domosdoshme në rrethana që ngërthejnë nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë. Kjo vlen posaçërisht në rrethana në të cilat, një seancë dëgjimore nuk është mbajtur as para shkallës më të ulët, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret.

67. Në fakt, në disa raste GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së kur një seancë dëgjimore nuk ishte mbajtur në një gjykatë me juridiksion apeli, edhe atëherë kur një seancë dëgjimore ishte mbajtur në instancën më të ulët, përkundër faktit se vlerësimi i domosdoshmërisë së seancës dëgjimore në nivel apeli është më pak rigoroz atëherë kur një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallën e parë. Për shembull, në Aktgjykimin Helmers kundër Suedisë, GJEDNJ shqyrtoi një rast në të cilin parashtruesit përkatës i ishte mundësuar një seancë dëgjimore në shkallën e parë, por jo në nivelin e apelit, e cila kishte kompetencë të vlerësonte edhe ligjin edhe faktet në rrethanat e rastit përkatës. Në këtë rast, GJEDNJ kishte ritheksuar se (i) garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, jo detyrimisht garantojnë një seancë dëgjimore në nivel apeli, nëse një e tillë është mbajtur në shkallën e parë; dhe (ii) në marrjen e këtij vendimi, gjykata përkatëse duhet gjithashtu të ketë parasysh nevojën për trajtimin ekspeditiv të rasteve si dhe të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Megjithatë, duke vënë theks në faktin se një përcaktim i tillë varet nga natyra e çështjeve që ngërthen një rast dhe nevojën për ekzistimin e rrethanave të veçanta në mënyrë që të justifikohet mungesa e një seance dëgjimore, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6

të KEDNJ-së (për arsyetimin përkatës të rastit, shih paragrafët 31 deri 39 të rastit Helmers kundër Suedisë).

68. Në fund, Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se Kolegji i Apelit nuk kishte arsyetuar "heqjen dorë nga seanca", por ishte mjaftuar vetëm me referim në nenin 69 të Ligjit 06/L-086 për DHPGJS-në. Ky i fundit, siç është sqaruar më lart, thjesht përcakton kompetencën e Kolegjit të Apelit për të vendosur për mbajtjen e seancës dëgjimore bazuar në nismën e tij ose me kërkesë të palës. Aktgjykimi përkatës nuk përmban asnjë sqarim shtesë lidhur me vendimin e Kolegjit të Apelit për të "hequr dorë nga seanca". Në këtë kontekst, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me mungesën e një seance dëgjimore, duhet të shqyrtohet edhe nëse refuzimi i mbajtjes së një seance të tillë është i arsyetuar. Për shembull në rastin e GJEDNJ-së Pönkä kundër Estonisë, (Aktgjykimi i 8 nëntorit 2016), e që ndërlidhej me zhvillimin e një procedure të thjeshtuar (e rezervuar për padi të vogla), GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, sepse gjykata përkatëse nuk kishte arsyetuar mungesën e një seance dëgjimore (shih rastin e GJEDNJ-së, Pönkä kundër Estonisë, cituar më lart, paragrafët 37-40). Gjithashtu, në rastin e GJEDNJ-së, Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë, cituar më lart, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, ndër të tjerash edhe pse gjykata përkatëse nuk kishte dhënë shpjegim për mosmbajtjen e një seance dëgjimore (shih rastin e GJEDNJ-së, Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë, cituar më lart, paragrafi 44). Në kontekst të mungesës së arsyetimit të mosmbajtjes së një seance dëgjimore, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, në mënyrë të vazhdueshme, ndër të tjera, ka theksuar se nga mungesa e arsyetimit rreth nevojës për mbajtjen e një seance dëgjimore, i pamundëson gjykatës më të lartë, të vlerësojë nëse një mundësi e tillë thjeshtë është neglizhuar, apo cilat janë argumentet bazuar në të cilat gjykata ka anashkaluar një mundësi të tillë në raport me rrethanat që ngre një rast i caktuar (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 80; dhe rastin e GJENDJ-së Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë, paragrafi 44 dhe referencat e përdoruara aty).

69. Prandaj, dhe në përfundim, Gjykata, duke marrë parasysh që (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar shprehimisht mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton se të njëjtit në mënyrë të nënkuptuar kanë hequr dorë nga kjo e drejtë, posaçërisht duke marrë parasysh që të njëjtit nuk kanë iniciuar ankesën para Kolegjit të Apelit dhe gjithashtu mungesa e kësaj

kërkesë, nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi për vlerësimin e domosdoshmërisë së një seance dëgjimore; (ii) përkundër kërkesës specifike të parashtruesve përkatës për seancë dëgjimore para Kolegjit të Specializuar, një e tillë nuk ishte mbajtur dhe rrjedhimisht, standardet që aplikohen për domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit janë më rigoroze, sepse, në parim, palët kanë të drejtë në një seancë dëgjimore të paktën para një instance gjyqësore; (iii) çështjet në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk mund të kualifikohen as si çështje ekskluzivisht ligjore dhe as çështje të natyrës teknike, por përkundrazi si çështje të faktit dhe ligjit; (iv) Kolegji i Apelit kishte vlerësuar mënyrën se si instanca më e ultë, përkatësisht Kolegji i Specializuar kishte bërë vlerësimin e fakteve, duke e ndryshuar Aktgjykimin e tij në dëm të parashtruesve të kërkesës; dhe (v) Kolegji i Apelit nuk e kishte arsyetuar "heqjen dorë nga seanca"; konstaton se në rastin konkret nuk kanë "ekzistuar rrethana të jashtëzakonshme për të justifikuar mungesën e një seance dëgjimore", dhe për pasojë, Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 81).

70. Gjykata në fund gjithashtu thekson, se duke marrë parasysh që tashmë ka konstatuar që Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së rrethanave të jashtëzakonshme të cilat do të mund të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës. Pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Për më tepër, duke marrë parasysh që Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për të shqyrtuar vendimet e kontestuara të Kolegjit të Specializuar bazuar në ligjet e aplikueshme për DHPGJS-në, i njëjti ka mundësinë e korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 *Parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 82).

71. Konstatimi i Gjykatës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet

ekskluzivisht me mungesën e seancës dëgjimore, siç është sqaruar në këtë Aktgjykim, dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me dhe as nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

Përfundim

72. Gjykata ka vlerësuar pretendimet e parashtruesve te kërkesës, përkitazi me mungesën e seancës dëgjimore në rrethanat e rastit të tyre, si një ndër garancitë e përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenit 6 të KEDNJ-së, duke mbështetur këtë vlerësim në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

73. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht ka shtjelluar parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika e saj gjyqësore dhe ajo e GJEDNJ-së, përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore, duke i sqaruar rrethanat në të cilat një e tillë është e domosdoshme, bazuar mes tjerash, në Aktgjykimin e Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë. Gjykata ka sqaruar, mes tjerash, se (i) mungesa e kërkesës së një pale për seancë dëgjimore jo detyrimisht nënkupton heqjen dorë nga një e drejtë të tillë dhe nëse mungesa e një kërkese të tillë nënkupton heqjen dorë të një pale nga kjo e drejtë, varet nga specifikat e ligjit dhe rrethanat e veçanta të një rasti; dhe (ii) në parim, palët kanë të drejtë në një seancë dëgjimore në të paktën një nivel të juridiksionit, përpos nëse "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore", e të cilat bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim ndërlidhen me raste në të cilat shqyrtohen "çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike".

74. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tyre nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtojë me nismën e tij domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore; (ii) parashtruesve të kërkesës iu është mohuar e drejta e seancës dëgjimore në të dy nivelet e DHPGJS-së; (iii) Kolegji i Apelit, nuk kishte trajtuar "çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike" dhe rrjedhimisht nuk "ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore"; (iv) Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar çështje "fakti dhe ligji" për më tepër që, kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar në dëm të parashtruesve të kërkesës; dhe (v) Kolegji i Apelit, nuk kishte arsyetuar "heqjen dorë nga seanca gojore". Duke marrë parasysh këto rrethana dhe arsyetimet e tjera të dhëna në këtë Aktgjykim, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht

Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore.

75. Gjykata gjithashtu theksoi se (i) bazuar në ligjin e aplikueshëm për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për vlerësimin e vendimeve të Kolegjit të Specializuar dhe rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka mundësinë e korrigjimit të mungesës së seancës dëgjimore në nivelin e gjykatës më të ulët, përkatësisht, Kolegjit të Specializuar; dhe (ii) nuk është e nevojshme të trajtohen pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës sepse të njëjtat duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit në përputhshmëri me konstatimet e këtij Aktgjykimi; dhe (iii) konstatimi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret ndërlidhet vetëm me garancitë procedurale për një seancë dëgjimore dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet, si dhe nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 27 janar 2021, me shumicë votash

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme;

IV. TË KTHEJË çështjen në rigjykim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi;

V. TË URDHËROJË Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me

rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës deri më 26 korrik 2021;

VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi

KI24/20, Parashtrues: "PAMEX SH.P.K", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.179/2017, të 11 nëntorit 2019

KI24/209, Aktgjykim i 3 shkurtit 2021, publikuar më 24 shkurt 2021

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, transfer i gabuar bankar, Ligji për Sistemin e Pagesave, vendim i paarsyetuar*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një transaksion të 21 qershorit 2013, në emër të parashtruesit të kërkesës tek një kompani kineze, të cilin e kishte realizuar Banka për Biznes në Prishtinë. Megjithatë, kjo e fundit, gabimisht kishte realizuar transakcionin në euro dhe jo në dollarë, duke rezultuar kështu me një pagesë shtesë prej 17,436.85 euro, në dëm të parashtruesit të kërkesës, si rezultat i dallimit në kursin valutor. Më pas, bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës dhe Banka kishin arritur një marrëveshje sipas së cilës (i) pjesa e transferit të realizuar gabimisht do t'i mbetej kompanisë kineze, prej të cilës parashtruesi i kërkesës do të porosiste mall shtesë; ndërsa (ii) Banka do t'i mundësonte parashtruesit të kërkesë një Kontratë për Mbitërheqje përmes të cilës, parashtruesi i kërkesës do e kompenzonte Bankën në lidhje me shumën e kontestuar brenda një periudhe të caktuar.

Në fillim të vitit 2015, parashtruesi i kërkesës iu drejtua gjykatave të rregullta, jo vetëm duke kërkuar kthimin e shumës së kontestuar por edhe kompenzimin e humbjeve të shkaktuara, si rezultat i veprimeve të Bankës përkatëse. Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte refuzuar si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës, pasi që kishte sqaruar se çështjet kontestuese që burojnë nga gabimi të cilin Banka e kishte bërë përmes transaksionit të 21 qershorit 2013, ishin zgjidhur me vullnetin e palëve përmes (i) deklaratës së nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës më 30 korrik 2013; dhe (ii) Kontratës për Mbitërheqje të nënshkruar më 31 korrik 2013. Parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar konstatimet e Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, ndër të tjera, duke theksuar faktin se në Gjykatën Themelore nuk është dëgjuar dëshmitari i propozuar prej tij dhe duke kërkuar caktimin e një superekspertize. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte pretenduar shkelje të dispozitave të Ligjit për Sistemin e Pagesave dhe më saktësisht, neneve 33, 34, 41 dhe 53 të tij. Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit të kontestuar kishte miratuar konstatimet e Gjykatës Themelore.

Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës pretendoi se Aktgjykimi [Ae.nr.179/2017] i 11 nëntorit 2019 i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E

Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës theksoi, ndër të tjera, se Gjykata e Apelit ka dështuar t'i arsyetojë pretendimet e tij, posaçërisht në lidhje me (i) kërkesën e tij për dëgjimin e dëshmitarit A.B.; (ii) kërkesën e tij përkitazi me superekspertizën; dhe (iii) shkeljet e neneve 33, 34, 41 e 53 të Ligjit të Pagesave.

Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, fillimisht Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndër të tjera, vuri theks në faktin që gjykatat janë të detyruara të arsyetojnë pretendimet e palëve që janë thelbësore apo që mund të jenë përcaktuese për meritat e një rasti. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu sqaroi se përkundër faktit që kur gjykatat me juridiksion apeli, konfirmojnë vendimet e gjykatave më të ulëta, nuk janë të detyruara të arsyetojnë secilin argument, ato megjithatë janë të detyruara që të tregojnë konsideratë të mjaftueshme në shqyrtimin e vendimit të shkallës më të ulët. Për më tepër, në vlerësimin e një vendimi të një gjykate më te ulët, gjykata më e lartë është po ashtu e detyruar të vlerësojë pretendimet ankimore të një parashtruesi, dhe jo vetëm të vlerësojë nëse gjykata më e ultë në mënyrë të drejtë e ka vlerësuar ankesën përkatëse para saj.

Në aplikimin e këtyre standardeve në rastin konkret, Gjykata konstatoi se në nxjerrjen e Aktgjykimit [Ae.nr.179/2017] të 11 nëntorit 2019, Gjykata e Apelit përtej dështimit për të arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me superekspertizën dhe mosdëgjimin e dëshmitarëve të caktuar, e njëjta në arsyetimin e saj nuk kishte përfshirë asnjë fjali të vetme përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të dispozitave të Ligjit për Sistemin e Pagesave, si pretendim thelbësor i parashtruesit të kërkesës. Ligji i lartcekur, në nenin 53 të tij, ndër të tjera, përcakton se asnjë marrëveshje me shkrim ndërmjet klientit dhe institucionit të pagesave nuk mund të përmbajë ndonjë dispozitë që paraqet heqje dorë nga ndonjë e drejtë e akorduar apo shkak veprimi të krijuar sipas këtij ligji. Bazuar në vlerësimin e Gjykatës, heshtja e Gjykatës së Apelit, përkitazi me pretendime të tilla thelbësore dhe përcaktuese të parashtruesëve përkatës, nuk i plotëson standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, siç është garantuar përmes Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Për pasojë, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës së Apelit, nuk është në përputhshmëri me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, dhe rrjedhimisht duhet të shpallet i pavlefshëm, dhe të kthehet në rivendosje në Gjykatën e Apelit.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI24/20

Parashtrues

"PAMEX SH.P.K"

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.179/2017,
të 11 nëntorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga "PAMEX SH.P.K", me pronar Vllaznim Shemsedini nga Komuna e Ferizajt (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Ae.nr.179/2017] e 11 nëntorit 2019 të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) lidhur me Aktgjykimin [III.EK.nr.201/15] e 25 majit 2017 të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

4. Më 29 janar 2020, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, të cilën e kishte dorëzuar përmes postës më 27 janar 2020.

5. Më 30 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.

6. Më 11 shkurt 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës. Gjykata gjithashtu kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta informojë Gjykatën nëse kundër Aktgjykimit të kontestuar kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) dhe nëse jo, të sqarojë arsyet e mosushtrimit të këtij mjeti juridik.

7. Më 20 shkurt 2020, Gjykata pranoi shkresën e parashtruesit të kërkesës, të dorëzuar me postë më 18 shkurt 2020, përmes së cilës informoi Gjykatën se kundër Aktgjykimit të kontestuar nuk kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme, duke arsyetuar se (i) kanë paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit sepse "*nga përvojat e mëhershme e dijmë që Prokuroria e*

Shtetit në këto kërkesa përgjigjet në afat rekord të shpejtë"; dhe (ii) "*përmes revizioni nuk kemi pasur mundësi ligjore të thirremi në shkelje kushtetuese dhe e kemi ditur që me paraqitjen e Revizionit do të kemi shumë vonesa nga përgjigjja e Gjykatës Supreme*".

8. Më 11 janar 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore dosjen e plotë të lëndës.

9. Më 14 janar 2021, Gjykata Themelore e dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës.

10. Më 3 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

11. Në të njëjtën ditë, Gjykata me shumicë konstatoi se (i) kërkesa është e pranueshme; dhe se (ii) Aktgjykimi [Ae.nr.179/2017] i 11 nëntorit 2019 i Gjykatës së Apelit nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 21 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Banka për Biznes në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Banka) që të bëjë transferimin e shumës prej 76,210.00 dollarësh tek kompania Shangshu Mingjia Kintting Co .Ltd Guli Tovn Changshu Jiangsu nga Kina (në tekstin e mëtejmë: kompania kineze). Banka kishte realizuar transferimin e pagesës përkatëse, por të njëjtën e kishte bërë në euro e jo në dollar, duke rezultuar kështu me një pagesë shtesë prej 17,436.85 euro apo 23,290.00 dollarë (në theksin e mëtejmë: shuma e kontestuar), në dëm të parashtruesit të kërkesës, si rezultat i dallimit në kursin valutor.

13. Më 22 korrik 2013, Banka i kishte drejtuar parashtruesit të kërkesës një konfirmim për pagesën e datës 21 qershor 2013, duke sqaruar edhe gabimin që ishte bërë nga Banka gjatë transferimit të pagesës për kompaninë kineze. Konfirmimi në fjalë gjithashtu sqaron se procedura për kthimin e shumës së kontestuar nga kompania kineze ishte suspenduar nga Banka, pasi që parashtruesi i kërkesës ishte pajtuar me kompaninë kineze që në vlerën e shumës së kontestuar, të pranojë mall nga kompania kineze. Ky konfirmim ishte nënshkruar edhe nga parashtruesi i kërkesës.

14. Më 30 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës kishte nënshkruar një deklaratë përmes së cilës deklaronte se kishte kërkuar nga Banka që t'i lejojë mbitërheqje (overdraft) prej 22,000.00 euro, nga e cila shumë parashtruesi i kërkesës do të kompensonte Bankën, për gabimin teknik të bërë nga zyrtarët e pagesave të Bankës, ndërsa shumën e lejuar për mbitërheqje, do të paguante sipas marrëveshjes së reflektuar në këtë deklaratë.

15. Më 31 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës dhe Banka kishin nënshkruar një Kontratë [Nr. KO413/498] për Mbitërheqje për Persona Juridik (në tekstin e mëtejmë: Kontrata për Mbitërheqje), përmes së cilës parashtruesi i kërkesës obligohet që t'ia paguajë shumën e kontestuar Bankës brenda një afati të caktuar.

16. Më 17 mars 2015, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Ferizaj kundër Bankës, duke kërkuar (i) kthimin e mjeteve në shumën e kontestuar, e të cilat ishin transferuar më 21 qershor 2013 tek kompania kineze gabimisht nga Banka; (ii) kompensimin e humbjeve të shkaktuara si rezultat i këtij transferi; si dhe (iii) kompensimin e shpenzimeve të tjera si pasojë e veprimeve të Bankës.

17. Më 17 prill 2015, Gjykata Themelore në Ferizaj kishte shpallur veten jo-kompetente për të shqyrtuar padinë dhe lëndën e kishte transferuar në Gjykatën Themelore.

18. Më 12 maj 2016, Banka kishte parashtruar përgjigje në padi përmes së cilës kishte kërkuar që Gjykata Themelore të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se (i) parashtruesi i kërkesës, nuk ka kërkuar që të bëhet ndërprerja e transferit dhe kthimi i mjeteve, por "*ka deklaruar se për diferencën e mjeteve nga USD ne EURO, do të marë mallë nga furnitori që vetëm e kishte planifikuar një gjë të tillë qysh më herët*"; (ii) për pasojë, parashtruesi i kërkesës, i ka mbetur borxh Bankës shumën e kontestuar, prandaj përmes deklaratës së 30 korrikut 2013, ka pranuar që "*shuma e diferencës është obligim i paditësit, ndërsa lut të paditurën që për borxhin nga diferenca në fjalë të lëshojë një kredi në formë të OVD-së*"; dhe (iii) parashtruesit të kërkesës i është miratuar kërkesa dhe është nënshkruar Kontrata për Mbitërheqjen.

19. Më 26 maj 2016, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore me shkresë për precizim të padisë, përmes së cilës, saktësoi se (i) Banka e kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës për gabimin e bërë gjatë transferit vetëm me datën 22 korrik 2013, përkatësisht një muaj pas transferit të realizuar gabimisht; (ii) Banka "*asnjëherë të*

vetme nuk ka dërguar ndonjë konfirmim me shkrim ose të vulosur se është duke bërë parapagim për marrësin e transferit në Kinë"; (iii) Banka është munduar që në mënyrë të njëanshme të zgjidhë problemin, duke bllokuar llogaritë bankare të tij "*pa paralajmërim*"; (iv) më 4 korrik 2013 dhe 5 korrik 2013, respektivisht, kishte deponuar në llogaritë e tij 15,000 euro dhe "*këto mjete u tërhoqën nga i padituri pa nënshkrimin dhe autorizimin e paditësit*"; (v) Banka i kishte mundësuar mbitërheqjen deri në 20,000 euro, mirëpo "*e padituara nga kjo shumë tërhoqi mjetet e paguara më shumë dhe e njoftoj paditësin se tani më nuk mund të tërheqë mjete nga kjo shumë e lejuar*"; (vi) më 28 prill 2014, parashtruesi i kërkesës, "*për shkak të vështirësive financiare tashmë të krijuara*", kishte aplikuar për kredi në shumën prej 20.000.00 euro dhe "*me qëllim të një zgjidhje të kënaqshme për të dyja palët ua kthen 8,000.00 € të dëmit që i është shkaktuar atij nga i padituri*", ndërsa më 13 maj 2014, është nënshkruar kredi e re në shumën prej 19,600.00 euro; dhe (vii) për shkak të pamundësisë që të realizojë transfere ndërkombëtare përmes bankës, "*i është rivlerësuar nga Dogana e Kosovës malli i importuar nga Turqia në shumën prej 5,200.00 €, mjete këto të cilat është dashur t'i paguajë më tepër*".

20. Bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht procesverbalet e seancave të mbajtura para Gjykatës Themelore (i) më 15 shtator 2016, rezulton se i padituri, përkatësisht Banka, ka propozuar dëgjimin e dëshmitarëve M.N. dhe S.Sh., ndërsa parashtruesi i kërkesës kishte propozuar dëgjimin e dëshmitarit A.B. dhe caktimin e ekspertizës me ekspertin financiar R.B. Përmes Aktvendimit, Gjykata Themelore miratoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për përcaktimin e ekspertizës nga eksperti i propozuar, duke theksuar se i njëjti, "*nëse është e nevojshme*", do t'i dëgjojë edhe dëshmitarët e propozuar nga palët; dhe (ii) më 12 maj 2017, ishte nxjerrë Aktvendimi për Administrimin e Provave, të cilin parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar, ndër të tjera, duke theksuar se pajtohet me konstatimet e ekspertit financiar dhe i cili gjithashtu kishte marrë parasysh vërejtjet e tij dhe nuk ka vërejtje në provat e propozuara.

21. Më 15 shkurt 2017, eksperti R.B. kishte paraqitur ekspertizën financiare në Gjykatën Themelore. Kjo ekspertizë, ndër të tjerash, thekson se (i) përkundër faktit që nuk ka të dhëna nëse parashtruesi i kërkesës e ka pranuar mallin nga kompania kineze, dhe rrjedhimisht nëse është dëmtuar në vlerën prej 76,212.00 euro dhe shumën e transferuar gabimisht nga Banka në vlerën prej 17,436.68 euro, Banka është përgjegjëse vetëm për këtë të fundit; (ii) sipas marrëveshjes në mes palëve, shuma e kontestuar nuk është suspenduar, por parashtruesi i kërkesës dhe Banka kanë nënshkruar Kontratën për

Mbitërheqje të 31 korrikut 2013 dhe parashtruesi i kërkesës është pajtuar që të kompenzojë Bankën për shumën e kontestuar, fillimisht në vlerën prej 12,000.00 euro, ndërsa pjesën e mbetur prej 5,436.85 euro, jo më vonë se më 15 gusht 2013; (iii) totali i detyrimit të mbetur të parashtruesit të kërkesës ndaj Bankës deri më 8 gusht 2016 është 13,201.72 euro; dhe (iv) ndëshkimi i Doganës së Kosovës, me rastin e rivlerësimit të mallit, nuk ndërlidhet me çështjen e transferit kontestues.

22. Më 25 maj 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [III.EK.nr.201/15] e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit të lartcekur, ndër tjera, theksoi se nuk ishte kontestues fakti që Banka gabimisht kishte transferuar vlerën kontestuese te kompania kineze, por kontestuese ishte nëse e paditura, përkatësisht Banka, i kishte borxh shumën e kontestuar paditësit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore kishte arsyetuar që ky nuk është rasti, duke u bazuar (i) në deklaratën e nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës më 30 korrik 2013; dhe (ii) Kontratën për Mbitërheqje të nënshkruar të nesërmen, përkatësisht më 31 korrik 2013, përmes së cilave ai merrte përsipër që t'i paguante Bankës shumën e kontestuar, pasi që ishte dakorduar me kompaninë kineze që në shkëmbim të shumës së kontestuar të pranonte mall. Gjykata Themelore, gjithashtu kishte theksuar se nuk mund ta vërtetojë faktin nëse parashtruesi i kërkesës në fakt e ka pranuar mallin nga kompania kineze, por për Gjykatën Themelore relevante ishte vetëm raporti juridik në mes paditësit dhe të paditurit dhe fakti se paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, me vullnetin e vet ka marrë përsipër që t'ia kompensojë të paditurit, përkatësisht Bankës, shumën e kontestuar.

23. Më 15 qershor 2017, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit. Parashtruesi i kërkesës, përmes kësaj ankese, ndër të tjera, pretendoi se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit të saj (i) gabimisht kishte konstatuar se ai kishte konfirmuar që Banka të ndërprejë procedurën për kthimin e mjeteve nga kompania kineze; (ii) gabimisht kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar se nënshkrimi në deklaratën e 30 korrikut 2013 është i tij; (iii) nuk kishte marrë për bazë kërkesën që për këtë çështje të dëgjohet dëshmitari, i punësuar në Bankë, përkatësisht A.B.; si dhe (iv) nuk kishte marrë parasysh shkeljet e Ligjit nr. 04/l-155 për Sistemin e Pagesave (në tekstin e mëtejmë: Ligji i Pagesave), përkatësisht nenin 33 (Autorizimi i Transferove), paragrafin 1 të nenit 34 (Urdhërpagesat e gabuara), nënparagrafin 1.2.1 të nenit 41 (Rrethanat kur klienti nuk është përgjegjës) dhe paragrafi 1 i nenit 53 (Heqja dorë nga të drejtat

dhe mbrojtja më e madhe) të tij. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kishte kërkuar nga Gjykata e Apelit që të bëhet një *"superekspertizë nga ekspert të pavarur"*. Më 27 qershor 2017, Banka kishte parashtuar përgjigje në ankesë, duke kundërshtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe duke i propozuar Gjykatës që ankesën përkatëse të refuzoj si të pabazuar, duke e miratuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

24. Më 11 nëntor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ae.nr.179/2017], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin [III.EK.nr.201/15] e 25 majit 2017 të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit vuri theks në (i) konfirmimin e 22 korrikut 2013 të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës; (ii) deklaratën e 30 korrikut 2013 të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës; dhe (iii) Kontratën për Mbitërheqje të nënshkruar me 31 korrik 2013 e të cilën palët kontraktuese e kishin nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë, dhe me këtë rast, parashtruesi i kërkesës kishte hequr dorë nga kthimi i mjeteve të paguara gabimisht në shkëmbim të mallit shtesë.

25. Më 11 dhjetor 2019, para Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur propozim për inicimin e kërkesës për mbrojte të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit.

26. Më 17 dhjetor 2019, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit përmes Njoftimit [KML.nr.195/2019] informoi parashtruesin e kërkesës se ishte refuzuar propozimi i tij për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [Ae.nr.179/2017] të 11 nëntorit 2019 të Gjykatës së Apelit, me arsyetimin se pretendimet e paraqitura nuk ishin të mjaftueshme sepse nuk ishte paraqitur asnjë "*arsyetim lidhur me aplikimin e gabueshëm të ndonjë dispozite konkrete të së drejtës materiale*" në kuptim të pikës b) të paragrafit 1 të nenit 247 [pa titull] të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [Ae.nr.179/2017] i 11 nëntorit 2019 i Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [III.EK.nr.201/15] e 25 majit 2017 të Gjykatës Themelore, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

28. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës, në esencë, pretendon mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata e Apelit ka dështuar të arsyetojë pretendimet e tij thelbësore si në vijim: (i) shkeljet e neneve 33, 34, 41 e 53 të Ligjit të Pagesave; (ii) kërkesën e tij për dëgjimin e dëshmitarit A.B., zyrtarë i lartë në Bankë, e përmes së cilit, sipas parashtruesit të kërkesës, do të dëshmohej se ai nuk ka kërkuar ndaljen e procedurës për kthimin e shumës së kontestuar nga kompania kineze; (iii) kërkesën e tij përkitazi me superekspertizën; dhe (iv) kundërshtimin e nënshkrimit të deklaratës të 30 korrikut 2013. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu konteston anshmërinë e gjyqtares F.I. që ka vendosur rastin e tij në Gjykatën Themelore.

29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) të shpall kërkesën e tij të pranueshme; dhe (ii) të anulojë Aktgjykimin [Ae.nr.179/2017] e 11 nëntorit 2019 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin [III.EK.nr.201/15] e 25 majit 2017 të Gjykatës Themelore, duke e kthyer rastin e tij në rivendosje në një trup tjetër gjykues.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]"

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E Drejta për një proces të rregullt)

1.Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]"

Ligjit nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave

Neni 33
(Autorizimi i Transferove)

1. Një transfer i fondeve konsiderohet i autorizuar vetëm nëse dërguesi ka dhënë miratim për ekzekutimin e një transferi të tillë.
2. Miratimi për ekzekutimin e një transferi të fondeve apo të një serie të transfereve jepet në formën e dakorduar nga palët.
3. Në mungesë të një miratimi të tillë, transferi konsiderohet si i paautorizuar.
4. Nëse institucioni i pagesave dhe klienti i tij pajtohen se vërtetësia e urdhërpagesave të lëshuara për institucionin e pagesave në emër të klientit si dërgues do të verifikohen sipas procedurës së sigurisë, urdhërpagesa e pranuar nga institucioni pranues është po aq e vlefshme sikurse urdhri i klientit, pavarësisht se a është ose jo e autorizuar, nëse:

4.1. procedura e sigurisë është një metodë e arsyeshme në aspektin e tregut të ofrimit të sigurisë kundër urdhërpagesave të paautorizuara; dhe

4.2. institucioni dëshmon se e ka pranuar urdhërpagesën në mirëbesim dhe në pajtueshmëri me procedurën e sigurisë dhe ndonjë marrëveshje apo instruksion me shkrim nga ana e klientit që kufizon pranimin e urdhërpagesave të lëshuara në emër të klientit. Institucioni nuk kërkohet që t'i përmbahet një udhëzimi që shkel marrëveshjen më shkrim me klientin apo njoftimi i të cilit nuk është pranuar në kohën dhe në mënyrën që institucionit i ofron

mundësi të arsyeshme që të veprojë në të para pranimit të urdhërpagesës.

[...]

Neni 34
(Urdhërpagesat e gabuara)

1. Kur një urdhërpagesë iniciohet nga paguesi, institucioni i pagesave të paguesit është përgjegjës ndaj paguesit për ekzekutimin e saktë të transaksionit të pagesës, përveç nëse institucioni i pagesave mund të dështmojë se gabimi ishte bërë nga paguesi, apo nëse institucioni i pagesave mund t'ia dështmojë paguesit dhe, kur është relevante, institucionit të pagesave të të paguarit, se institucioni i pagesave të të paguarit e ka pranuar në mënyrë të saktë transaksionin e pagesës, ku në këtë rast, institucioni i pagesave të të paguarit është përgjegjës ndaj të paguarit për ekzekutimin e saktë të transaksionit të pagesës.

[...]

Nenit 41
(Rrethanat kur klienti nuk është përgjegjës)

1. Klienti nuk është përgjegjës për dëmin që:

1.1. nuk i atribuohet apo për të cilin nuk ka kontribuar klienti;

1.2. shkaktohet nga sjellja mashtruese apo e pakujdesshme e zyrtarëve të apo agjentëve të emëruar nga:

1.2.1 institucioni;

1.2.2. kompanitë dhe institucionet tjera të përfshira në aranzhimet e rrjeteve; apo 1.2.3. tregtarët të cilat janë të lidhur me kartelën apo me sistemin tjetër të komunikimit.

1.3. ka të bëjë më një kartelë që është falsifikuar, është e gabuar, e skaduar, apo

1.4. ndodhë para se klienti të ketë pranuar kartelën e tij apo kodin e sigurisë së qasjes.

2. Në rast të lindjes së ndonjë kontesti lidhur me kartelën e klientit, konsiderohet se klienti nuk e ka pranuar kartelën, përveç nëse mund të dështmohet ndryshe nga institucioni.

Neni 53
(Heqja dorë nga të drejtat dhe mbrojtja më e madhe)

1. Asnjë marrëveshje me shkrim ndërmjet klientit dhe institucionit të pagesave nuk mund të përmbajë ndonjë dispozitë

që paraqet heqje dorë nga ndonjë e drejtë e akorduar apo shkak veprimi të krijuar sipas këtij ligji.
2. Asgjë në këtë ligj nuk parandalon ndonjë marrëveshje, e cila i jep klientit më shumë të drejtat shtesë, apo masa përmirësuese a mbrojtje më të madhe sesa ato të parapara në këtë ligj.
[...]"

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

32. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

33. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".

34. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridik. (Shih, rastin e Gjykatës KI41/09, me parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; KI35/18, me parashtrues "*Bayerische Versicherungsverbrand",* Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40; dhe KI227/19, me parashtrues *N.T. "Spahia Petrol",* Aktgjykim i 20 dhjetorit 2020, paragrafi 37).

35. Ndërsa, për sa i përket përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj e të elaboruara më lart, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Ae.nr.179/2017] e 11 nëntorit 2019 të Gjykatës së Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

36. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

37. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me një transaksion të 21 qershorit 2013, në emër të parashtruesit të kërkesës tek një kompani kineze, të cilin e kishte realizuar Banka. Megjithatë, kjo e fundit, gabimisht kishte realizuar transakcionin në euro dhe jo në dollarë, duke rezultuar kështu me një pagesë shtesë prej 17,436.85 euro, në dëm të parashtruesit të kërkesës, si rezultat i dallimit në kursin valutor. Më pas, bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës dhe Banka kishin arritur një marrëveshje sipas së cilës (i) pjesa e transferit të realizuar gabimisht do t'i mbetej kompanisë kineze, prej të cilës parashtruesi i kërkesës do të porosiste mall shtesë; ndërsa (ii) Banka do t'i mundësonte parashtruesit të kërkesë një Kontratë për Mbitërheqje përmes të cilës, parashtruesi i kërkesës do e kompenzonte Bankën në lidhje me shumën e kontestuar brenda një periudhe të caktuar. Nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka të dhëna nëse parashtruesi i kërkesës e ka pranuar mallin e porositur nga kompania kineze.

38. Në fillim të vitit 2015, parashtruesi i kërkesës iu drejtua gjykatave të rregullta, jo vetëm duke kërkuar kthimin e shumës së kontestuar por edhe kompenzimin e humbjeve të shkaktuara, si rezultat i veprimeve të Bankës përkatëse. Gjykata Themelore kishte urdhëruar një ekspertizë e cila kishte konstatuar se çështja e vetme kontestuese në rrethanat e këtij rasti, është dëmi që mund t'i jetë shkaktuar parashtruesit të kërkesës si rezultat i gabimit të Bankës. Ekspertiza kishte analizuar kronologjinë e veprimeve të Bankës dhe të parashtruesit të kërkesës dhe kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës kishte obligime shtesë ndaj Bankës në vlerën prej 13,201.72 euro. Gjykata Themelore, kishte refuzuar si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës, pasi që kishte sqaruar se çështjet kontestuese që burojnë nga gabimi të cilin Banka e kishte bërë përmes transaksionit të 21 qershorit 2013, ishin zgjidhur me vullnetin e palëve përmes (i) deklaratës së nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës më 30 korrik 2013; dhe (ii) Kontratës për Mbitërheqje të nënshkruar më 31 korrik 2013. Parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar konstatimet e Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, kryesisht përkitazi me vlerësimin e gabuar të fakteve, ndër të tjera, duke theksuar faktin se në Gjykatën Themelore nuk është dëgjuar dëshmitari i propozuar prej tij dhe duke kërkuar caktimin e një superekspertize. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte pretenduar shkelje të dispozitave të Ligjit për Sistemin e Pagesave dhe më saktësisht, neneve 33, 34, 41 dhe 53 të tij. Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit të kontestuar kishte miratuar konstatimet e Gjykatës Themelore. Në vijim, gjithashtu Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kishte refuzuar

propozimin e parashtruesit të kërkesës për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës pretendon se ky Aktgjykim, përkatësisht Aktgjykimi [Ae.nr.179/2017] i 11 nëntorit 2019 i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor. Siç është sqaruar më lart, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës thekson se Gjykata e Apelit ka dështuar t'i arsyetojë pretendimet e tij, posaçërisht në lidhje me (i) kërkesën e tij për dëgjimin e dëshmitarit A.B.; (ii) kërkesën e tij përkitazi me superekspertizën; dhe (iii) shkeljet e neneve 33, 34, 41 e 53 të Ligjit të Pagesave.

39. Këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, dhe në vijim, Gjykata do t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me mungesën e vendimit të arsyetimit gjyqësor, shqyrtim ky në të cilin, Gjykata fillimisht (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme; dhe me pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën në vendim të arsyetuar gjyqësor

40. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës,* Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj

Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, me parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, me parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, me parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu,* Aktgjykim i 27 majit 2019; KI35/18, me parashtrues "*Bayerische Versicherungsverbrand",* cituar më lart; dhe KI227/19, me parashtrues *N.T. "Spahia Petrol",* cituar më lart, paragrafi 45.

41. Në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; gjithashtu për më shumë detaje në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së të 31 gusht 2020, E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil), IV. Kërkesat Procedurale, 7. Arsyetimet e Vendimeve Gjyqësore, paragrafët 371 deri 382 dhe referencat e përdoruara aty). Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar me të vërtetë, dhe për pasojë kontribuon në një pranueshmëri më të madhe të vendimeve. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Magnin kundër Francës*, Vendim i 10 majit 2012, paragrafi 29). Kjo praktikë gjyqësore gjithashtu përcakton se përkundër faktit që një gjykatë ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë aktivitetet dhe vendimmarrjen e saj duke dhënë arsyet përkatëse. (Shih, rastet e GJEDNJ-së: *Suominen kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 36; *Carmel Saliba kundër Maltës*, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73; shih po ashtu rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues N.T. "*Spahia Petrol",* cituar më lart, paragrafi 46). Për më tepër, vendimet duhet të jenë të arsyetuara në atë mënyrë që t'u mundësojë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Hirvisaari kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 30).

42. Thënë këtë, neni 6 i KEDNJ-së i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 61; *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, Vendim i 29 gushtit 2000; *Perez kundër Francës*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81; dhe shih po ashtu rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues *N.T.* "*Spahia Petrol",* cituar më lart, paragrafi 47). Masa në të cilën zbatohet ky detyrim mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në

dritën e rrethanave të secilit rast. (Shih, rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 27; dhe shih po ashtu rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues *N.T. "Spahia Petrol",* cituar më lart, paragrafi 47). Për shembull, një gjykatë apeli, mundet, në parim, të refuzojë një ankesë duke miratuar arsyet e vendimit të gjykatës më të ulët, megjithatë edhe një vendim i tillë duhet të përmbajë mjaftueshëm arsyetim për të treguar se gjykata përkatëse nuk ka miratuar konstatimet e arritura nga një gjykatë më e ulët pa konsideratë të mjaftueshme. (Shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, *Tatishvili kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 62; shih po ashtu rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues *N.T.* "*Spahia Petrol",* cituar më lart, paragrafi 47).

43. Megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nga gjykatat kërkohet që të shqyrtojnë dhe japin përgjigje specifike dhe të qarta në lidhje me (i) pretendimet dhe argumentet thelbësore të palës (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Donadze kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykim i 3 marsit 2006, paragrafi 35); (ii) pretendimet dhe argumentet që janë vendimtare për rezultatin e procedurës (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 30; dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28); ose (iii) pretendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96 dhe referencat në të; dhe gjithashtu shih rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues *N.T.* "*Spahia Petrol",* cituar më lart, paragrafi 48).

(ii) Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

44. Gjykata fillimisht rikujton që Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [III.EK.nr.201/15] e kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit të kontestuar, kishte miratuar konstatimet e Gjykatës më të ulët, duke vënë theks në "*vullnetin e palëve*" për të zgjidhur mosmarrëveshjen përkatëse, duke rikujtuar posaçërisht (i) konfirmimin e datës 22 korrik 2013 të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës; (ii) deklaratën e 30 korrikut 2013 të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës; dhe (iii) Kontratën për Mbitërheqje të nënshkruar me 31 korrik 2013. Por, bazuar në shkresat e lëndës, para Gjykatës së Apelit, përmes ankesës së parashtruesit të kërkesës, ndër të tjerash, ishin ngritur edhe tri pretendime specifike, duke përfshirë (i) shkeljen e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht nenin 33, paragrafin 1 të nenit 34,

nënparagrafin 1.2.1 të nenit 41 dhe paragrafin 1 të nenit 53 të Ligjit për Sistemin e Pagesave; (ii) kërkesën për një superekspertizë; dhe (iii) mos dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar prej tij në nivel të Gjykatës Themelore. Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës thekson se asnjëra prej këtyre pretendimeve nuk është adresuar nga Gjykata e Apelit, duke pretenduar për pasojë, shkelje të së drejtës së tij në një vendim të arsyetuar gjyqësor, siç është garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

45. Gjykata rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, gjykatat me juridiksion apeli, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret, janë të detyruara të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument. Ato munden, në parim, të refuzojnë një ankesë duke miratuar arsyet e vendimit të gjykatës më të ulët. Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret, Gjykata e Apelit e ka refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke miratuar qëndrimin dhe arsyetimin e Gjykatës Themelore. Thënë këtë, bazuar në të njëjtën praktikë gjyqësore, edhe vendimet e tilla, duhet të përmbajnë mjaftueshëm arsyetim për të treguar se gjykata përkatëse, në këtë rast Gjykata e Apelit, nuk ka miratuar konstatimet e arritura nga një gjykatë më e ulët, përkatësisht Gjykata Themelore, pa një konsideratë të mjaftueshme. (Shih, rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues *N.T. "Spahia Petrol",* cituar më lart, paragrafi 54 dhe referencat e përdorura aty).

46. Përkitazi me konsideratën e mjaftueshme që duhet të tregojnë gjykatat me juridiksion apeli kur miratojnë vendimet e gjykatave më të ulëta dhe masën e nevojshme të arsyetimit të vendimit gjyqësor në rrethana të tilla, Gjykata rikujton rastin e GJEDNJ-së *Tatishvilli kundër Rusisë* (Aktgjykim i 22 shkurtit 2007), në të cilin GJEDNJ, kishte vlerësuar një rast që ndërlidhej me kërkesën e një parashtruese për regjistrim të banimit. Të gjitha shkallët administrative dhe gjykatat respektive i kishin refuzuar pretendimet e parashtrueses përkatëse. (Për faktet e rastit shih paragrafët 7 deri më 19 të rastit të GJEDNJ-së *Tatishvilli kundër Rusisë,* cituar më lart). GJEDNJ kishte konstatuar, ndër tjerash, shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një vendimi të arsyetuar gjyqësor dhe cenimit të së drejtës në një gjykim të drejtë, sepse gjykata përkatëse e cila ishte përgjegjëse për të vlerësuar vendimin e gjykatës më të ultë, thjeshtë, në mënyrë përmbledhëse dhe pa konsideratë të mjaftueshme, kishte miratuar arsyetimin e gjykatës më të ultë, pa i adresuar pretendimet përkatëse të parashtrueses, duke dështuar kështu të korrigjojë të metat e vendimit paraprak. (Për arsyetimin përkatës, shih paragrafët 55 deri

më 63 të rastit të GJEDNJ-së *Tatishvilli kundër Rusisë,* cituar më lart).

47. Për të konstatuar nëse, në rrethanat e rastit konkret, arsyetimi i dhënë nga Gjykata e Apelit përmbush standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, përkatësisht reflekton konsideratë të mjaftueshme në vlerësimin e vendimit të gjykatës më të ulët, bazuar në parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, siç janë shtjelluar më lart, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit në Aktgjykimin e kontestuar [Ae.nr.179/2017] të 11 nëntorit 2019 të Gjykatës së Apelit, ku theksohet si në vijim:

> "*Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale pasi paditësit me të paditurën e ka zgjidhur çështjen kontestuese ndërmjet tyre dhe këtë në bazë të vullnetit të lirë e kanë formalizuar me Kontratën për Mbitërheqje Nr. K0413/498, të datës 31.07.2013. Nga parashtresa e të paditurës (konfirmim për pagesën e datës 21.06.2013) e datës 22.07.2013, të cilën e ka nënshkruar paditësi, rrjedh se paditësi ka qenë i njoftuar për procedurat dhe nuk ka kërkuar kthimin e mjeteve të transferuara, andaj e paditura me pëlqimin e paditësit ka stopuar procedurën e kthimit të fondeve nga përfituesi. Pas kësaj paditësi ka dhënë deklaratën e datës 30.07.2013, kopje të të cilës (e nënshkruar nga paditësi) gjendet në shkresat e lëndës, me të cilën pranon marrëveshjen për rregullimin e lëshimit në transfer.*
> *[...]*
> *Paditësi me padi pretendon kthimin e mjeteve të transferuara gabimisht dhe kompensimin e dëmit, por vullnetarisht ka hequr dorë nga kthimi i atyre mjeteve dhe me asnjë provë nuk ka arritur ta argumentoj se ka pësuar dëm si pasojë e transferit të gabuar nga ana e të paditurës.*"

48. Bazuar në arsyetimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit, Gjykata vëren se e njëjta refuzimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës të parashtruara përmes ankesës përkatëse dhe për pasojë, miratimin e Aktgjykimit të Gjykatës më të ulët, e bazon kryesisht në (i) "*vullnetin e lirë*" të palëve për të formalizuar Kontratën për Mbitërheqje; dhe (ii) "*vullnetin*" e parashtruesit të kërkesës për të hequr dorë nga kthimi i atyre mjeteve, përkatësisht mjeteve të cilat fillimisht ishin transferuar gabimisht nga Banka si rezultat i dallimeve në kursin valutor, sipas kushteve të përcaktuar në deklaratën përkatëse. Gjykata megjithatë vëren, se në arsyetimin e Gjykatës së Apelit, nuk ka asnjë referencë apo arsyetim përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur

me mosdëgjimin e dëshmitarëve të propozuar prej tij në nivel të Gjykatës Themelore, superekspertizën dhe as lidhur me shkeljen e pretenduar të dispozitave të Ligjit për Sistemin e Pagesave, çështje kjo të cilën, parashtruesi i kërkesës e kishte ngritur specifikisht para Gjykatës së Apelit.

49. Gjykata thekson se Ligji për Sistemin e Pagesave, i kushton një kapitull të veçantë, përkatësisht Kapitullin III, transfereve të paautorizuara dhe të gabuara të fondeve, duke përcaktuar edhe të drejtat e konsumatorëve, nëse ndodhin transakcione bankare të tilla. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret (i) në nenin 33 të tij, Ligji i lartcekur përcakton, mes tjerash, transferet që konsiderohen të paautorizuara, duke specifikuar se një transfer i fondeve konsiderohet i autorizuar vetëm nëse dërguesi ka dhënë miratim për ekzekutimin e një transferi të tillë; (ii) në nenin 34 të tij, Ligji i lartcekur rregullon çështjet e urdhërpagesave të gabuara dhe përgjegjësinë përkatëse të institucionit të pagesave, ku mes tjerash specifikohet se kur një urdhërpagesë iniciohet nga paguesi, institucioni i pagesave është përgjegjës ndaj paguesit për ekzekutimin e saktë të transaksionit të pagesës; ndërsa (iii) në nenin 41 të tij, Ligji i lartcelur liston rrethanat në të cilat klienti nuk është përgjegjës për dëmet e shkaktuara si rezultat i transfereve të paautorizuara, duke përfshirë edhe rastet kur një dëm i tillë shkaktohet nga pakujdesia e zyrtarëve të institucioneve.

50. Për më tepër, dhe më e rëndësishme lidhur me rastin konkret, neni 53 i Ligjit të Sistemit të Pagesave, përcakton mënyrën e heqjes dorë nga të drejtat dhe mbrojtjen më të madhe të klientëve, duke përcaktuar në mënyrë specifike që *"[A]snjë marrëveshje me shkrim ndërmjet klientit dhe institucionit të pagesave nuk mund të përmbajë ndonjë dispozitë që paraqet heqje dorë nga ndonjë e drejtë e akorduar apo shkak veprimi të krijuar sipas këtij ligji"*. I njëjti nen gjithashtu përcakton se asgjë në këtë ligj, përkatësisht Ligjin për Sistemin e Pagesave, nuk parandalon ndonjë marrëveshje, e cila i jep klientit më shumë të drejta shtesë, apo masa përmirësuese e mbrojtje më të madhe sesa ato të parapara në këtë ligj.

51. Në rrethanat e rastit konkret, bazuar në shkresat e lëndës, ashtu siç kanë vlerësuar edhe gjykatat e rregullta, nuk është kontestuese se (i) më 30 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës kishte nënshkruar një deklaratë përmes të cilës kishte deklaruar se kishte kërkuar nga Banka që t'i lejojë mbitërheqje prej 22,000.00 euro, nga e cila shumë i njëjti do të kompensonte Bankën, për gabimin teknik të bërë nga zyrtarët e pagesave të Bankës, ndërsa shumën e lejuar për mbitërheqje, do të paguante sipas marrëveshjes të reflektuar në këtë deklaratë; dhe (ii) më 31 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës dhe Banka kishin

nënshkruar një Kontratë për Mbitërheqje, përmes të cilës parashtruesi i kërkesës ishte obliguar që t'ia paguajë shumën e kontestuar Bankës për një afat të caktuar.

52. Gjykata megjithatë thekson se përkundër faktit që mund të mos jetë kontestuese se marrëveshja në mes palëve përkatëse është arritur me vullnetin e tyre, ashtu siç ka vlerësuar Gjykata e Apelit, neni 53 i Ligjit për Sistemin e Pagesave, nen ky shkeljen e të cilit parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendonte se është shkelur para Gjykatës së Apelit, në mënyrë shprehimore përcakton kufizime përkitazi me marrëveshjet me shkrim ndërmjet klientit dhe institucionit të pagesave, në mënyrë që të parët të jenë të mbrojtur nga të dytët, duke përcaktuar se asnjë marrëveshje ndërmjet klientit dhe institucionit të pagesave nuk mund të përmbajë dispozita me të cilat klientët heqin dorë nga të drejtat e garantuara sipas Ligjit për Sistemin e Pagesave.

53. Gjykata, megjithëse nuk mund të vlerësojë nëse marrëveshja e arritur në mes parashtruesit të kërkesës dhe Bankës ngërthen heqjen dorë nga ndonjë e drejtë e parashtruesit të kërkesës, apo edhe nëse neni 53 i Ligjit për Sistemin e Pagesave është i aplikueshëm në kontestin konkret, Gjykata megjithatë thekson se një pretendim i tillë, që ndërlidhet me shkeljen e dispozitave ligjore, është thelbësorë dhe mund të jetë edhe përcaktues, lidhur me meritat e padisë së parashtruesit të kërkesës.

54. Gjykata, duke u bazuar në praktikën e vet gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në kuptim të një vendimi të arsyetuar gjyqësor, i detyron gjykatat të arsyetojnë (i) pretendimet dhe argumentet thelbësore të palës; (ii) pretendimet dhe argumentet që mund të jenë vendimtare për rezultatin e procedurës; ose (iii) pretendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

55. Në rrethanat e rastit konkret, pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e dispozitave të caktuara të Ligjit për Sistemin e Pagesave, janë pretendime thelbësore të parashtruesit të kërkesës, dhe si të tilla, e ngarkojnë gjykatën përkatëse, në këtë rast Gjykatën e Apelit, me detyrimin për të adresuar dhe për të arsyetuar të njëjtat. Përkundër këtij detyrimi, në rrethanat e rastit konkret, përtej dështimit për të arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me superekspertizën dhe mosdëgjimin e dëshmitarëve të caktuar, e njëjta në arsyetimin e saj nuk ka përfshirë asnjë fjali të vetme përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të dispozitave të Ligjit për Sistemin e Pagesave.

56. Gjykata gjithashtu thekson, që në vlerësimin e një vendimi të një gjykate më të ulët, gjykata më e lartë është po ashtu e detyruar të vlerësojë pretendimet ankimore të një parashtruesi, dhe jo vetëm të vlerësojë nëse gjykata më e ultë në mënyrë të drejtë ka vlerësuar ankesën përkatëse para saj. Për më tepër, Gjykata gjithashtu thekson se qëllimi parësorë i një vendimi të arsyetuar gjyqësor është që tu tregojë palëve se çështja e tyre është dëgjuar me të vërtetë, duke rezultuar kështu në një pranueshmëri më të madhe të vendimeve gjyqësore. Në këtë aspekt, jodetyrimisht është relevante nëse pretendimet e palëve janë meritore për një rast në vlerësim para një gjykate. Varësisht nga natyra e çështjes para saj, gjykata përkatëse është e detyruar t'i adresojë të paktën ato pretendime të cilat janë thelbësore apo përcaktuese për meritat e një rasti.

57. Heshtja e gjykatave përkitazi me pretendime me rëndësi të parashtruesëve përkatës është shqyrtuar specifikisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Për shembull, në rastet, *Ruiz Torija kundër Spanjës,* cituar më lart dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, GJEDNJ, përtej parimeve të përgjithshme përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, gjithashtu kishte adresuar rrethanat në të cilat gjykatat përkatëse kishin heshtur lidhur me argumentet, të cilat GJEDNJ i cilësoi si thelbësore. Në të dy rastet, GJEDNJ shqyrtoi nëse heshtja e gjykatës përkatëse mund të interpretohet në mënyrë të arsyeshme si një refuzim i nënkuptuar i argumenteve të palëve. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28). Megjithatë, në mungesë të arsyetimit përkatës, GJEDNJ theksoi se është e pamundur të konstatohet nëse gjykatat përkatëse thjesht kanë neglizhuar të merren me pretendimet përkatëse apo kanë nënkuptuar refuzimin e tyre dhe, nëse ky ishte qëllimi i saj, cilat ishin arsyet e saj për një qasje të tillë. (Shih, rastet e GJEDNJ-së: *Hiro Balani kundër Spanjës,* cituar më lart, paragrafi 28; dhe *Ruiz Torija kundër Spanjës,* cituar më lart, paragrafi 29 dhe 30). Në të dy rastet, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

58. Në rrethanat e rastit konkret, duke marrë parasysh që Gjykata e Apelit, ka dështuar të adresojë dhe arsyetojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës të ngritura para saj përmes ankesës kundër Aktgjykimit [III.EK.nr.201/15] të 25 majit 2017 të Gjykatës Themelore, është gjithashtu e pamundur të konstatohet nëse Gjykata e Apelit thjesht ka neglizhuar të merret me pretendimet përkatëse apo ka nënkuptuar refuzimin e tyre dhe, nëse ky ishte qëllimi i saj, cilat ishin arsyet e saj për një qasje të tillë. Një vendim gjyqësor i tillë, nuk mund të jetë kompatibil me standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, siç janë të përcaktuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në

lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe praktikës përkatëse gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së.

59. Prandaj, duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konsideron që Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, përkatësisht Aktgjykimi [Ae.nr.179/2017] i 11 nëntorit 2019, është nxjerrë në shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse ka dështuar të adresojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht neneve 33, 34 e 41 dhe posaçërisht, nenit 53 të Ligjit për Sistemin e Pagesave.

60. Gjykata, në fund gjithashtu thekson, se duke marrë parasysh që ajo tashmë ka konstatuar që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës. Pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, duhet të shqyrtohen nga Gjykata e Apelit, përgjatë rishqyrtimit të Aktgjykimit të saj, (i) në raport me ankesën e parashtruesit të kërkesës parashtruar para saj; dhe (ii) konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu thekson se konstatimi i saj për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet ekskluzivisht me mungesën e arsyetimit të vendimit gjyqësor, siç është sqaruar në këtë Aktgjykim, dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me dhe as nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

Përfundime

61. Gjykata i ka shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar mbi këtë vlerësim praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, garanci kjo, e përcaktuar përmes nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

62. Përgjatë këtij vlerësimi, Gjykata ka konstatuar se në nxjerrjen e Aktgjykimit [Ae.nr.179/2017] të i 11 nëntorit 2019, Gjykata e Apelit ka dështuar të arsyetojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës. E njëjta, nuk ka arsyetuar me asnjë fjali të vetme, pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e dispozitave të Ligjit për Sistemin e Pagesave.

63. Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ndër të tjera, vuri theks në faktin që gjykatat janë të detyruara të arsyetojnë pretendimet e palëve që janë thelbësore apo që mund të jenë përcaktuese për meritat e një rasti. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu sqaroi, se përkundër faktit që kur gjykatat me juridiksion apeli, konfirmojnë vendimet e gjykatave më të ulëta, nuk janë të detyruara të arsyetojnë secilin argument, ato megjithatë janë të detyruara që të tregojnë konsideratë të mjaftueshme në shqyrtimin e vendimit të shkallës më të ulët. Për më tepër që, në vlerësimin e një vendimi të një gjykate më te ulët, gjykata më e lartë është po ashtu e detyruar të vlerësojë pretendimet ankimore të një parashtruesi, dhe jo vetëm të vlerësojë nëse gjykata më e ultë në mënyrë të drejtë e ka vlerësuar ankesën përkatëse para saj. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata, bazuar në të gjitha sqarimet e dhëna në këtë Aktgjykim, konsideron se nuk është rasti.

64. Për pasojë, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës së Apelit, nuk është në përputhshmëri me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, dhe rrjedhimisht duhet të shpallet i pavlefshëm, dhe të kthehet në rivendosje në Gjykatën e Apelit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 shkurt 2021, me shumicë:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ae.nr.179/2017] të 11 nëntorit 2019;

IV. TË KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ae.nr.179/2017] të 11 nëntorit 2019, për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TË URDHËROJË Gjykatën e Apelit që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më datën 2 gusht 2021, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;

VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI86/18, Parashtruese: Slavica Đordević, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CA.nr.2093/2017, të 29 janarit 2018

KI86/18, Aktgjykim, i 3 shkurtit 2021, publikuar më 11 mars 2021

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, e drejta për mjete juridike, kërkesë e pranueshme, shkelje e të drejtave kushtetuese*

Nga shkresat e rastit rezulton se në vitin 1997 parashtruesja e kërkesës kishte filluar ndërtimin e një objekti banimi në parcelën ndërtimore nr. 65 C, pjesë e ngastrës kadastrale nr. 7140/1, në Prizren, të cilat punime më vonë ishin ndërprerë si rezultat i luftës në Kosovë. Pas vitit 1999, parcela në fjalë ishte uzurpuar nga B.M. Ky i fundit kishte ndërtuar edhe dy kate të tjera mbi konstruksionin ekzistues të objektit të banimit në ndërtim e sipër që parashtruesja e kërkesës e kishte filluar, por që nuk kishte arritur ta mbaronte.

Pas këtyre zhvillimeve, parashtruesja e kërkesës në cilësi të pronares kishte paraqitur kërkesë në Komisionin për Çështje Pronësore Banesore për kthimin e pronës kontestuese në posedim të saj.

Përmes Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, ishte vërtetuar se parashtruesja e kërkesës: (i) gëzon të drejtën e shfrytëzimit të pronës që është objekt kryesor kontesti në këtë rast; dhe se (ii) prona në fjalë duhet t'i kthehet asaj në posedim në një afat prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e Vendimit të Komisionin për Çështje Pronësore Banesore.

Duke qenë se prona në fjalë nuk ishte liruar nga personi që e kishte uzurpuar atë, parashtruesja e kërkesës iu kishte drejtuar Gjykatës Komunale në Prizren me kërkesë që prona lëndore t'i kthehet në riposedim. Gjykata Komunale në Prizren, përmes Aktgjykimit [C.nr.462/10] kishte aprovuar kërkesën, Aktgjykim ky i cili ishte vërtetuar nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme.

Pas përfundimit të procedurave të lartcekura për vërtetim pronësie para gjykatave të rregullta, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur kërkesë për përmbarim të Aktgjykimit [C.nr.462/10] të Gjykatës Komunale, të 21 dhjetorit 2011, kërkesë kjo që ishte aprovuar nga Gjykata Themelore dhe nga Gjykata e Apelit. Lidhur me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale ishte caktuar një kompani ndërtimore, e cila kishte caktuar një shumë prej 19.495,42 euro për rrënimin e kateve që B.M. kishte ndërtuar në

pronën e parashtrueses së kërkesës, pasi që të njëjtën e kishte uzurpuar në vitin 1999.

Parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar që të lirohet nga pagesa e shpenzimeve të përmbarimit duke u thirrur në gjendje të rëndë financiare dhe në pamundësi të pagesës së shumës prej 19.495,42 euro. Kërkesën e tillë, Gjykata Themelore në Prizren e kishte refuzuar me arsyetimin se meqë pala debitore, B.M., nuk e kishte deponuar shumën e domosdoshme të kërkuar për ekzekutimin e punimeve lidhur me rrënimin e objektit, me arsyetimin se është rregull që paraprakisht si paradhënie ato shpenzime t'i paguajë kreditori, respektivisht parashtruesja e kërkesës në rrethana të rastit konkret. Gjykata Themelore kishte kërkuar dhënien e mendimit ligjor nga Gjykata Supreme se si duhet të veprohej në situatën kur debitori nuk paguan shpenzimet, ndërkaq që kreditori nuk ka mundësi financiare t'i paguaj ato. Gjykata Supreme, duke u thirrur në nenin 13 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, kishte theksuar se shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbarimit paraprakisht paguan kreditori, respektivisht parashtruesja e kërkesës në rastin konkret. Krejt në fund, Gjykata Themelore duke u bazuar kryesisht në mendimin juridik të Gjykatës Supreme obligon parashtruesen e kërkesës që të paguajë paraprakisht shpenzimet përmbarimore, duke theksuar se nëse e njëjta nuk i paguan atëherë Gjykata Themelore do t'a pezullojë procedurën në këtë rast. Ky Vendim i Gjykatës Themelore ishte vërtetuar dhe konsideruar i drejtë edhe nga Gjykata e Apelit.

Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës i konteston dy vendimet e fundit, përkatësisht vendimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit që kanë rezultuar me pezullimin e procedurës përmbarimore.

Parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e saj kushtetuese të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe me nenet përkatëse të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nenin 6 paragrafi 1 [E drejta për gjykim të drejtë]; neni 13 [E drejta për mjete efektive juridike]; nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ [Mbrojtja e pronës]; nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit], si dhe me nenet përkatëse të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, respektivisht neni 2, neni 8, neni 10 dhe neni 17. Parashtruesja e kërkesës kërkoi që identiteti i saj të mos zbulohet, pa dhënë ndonjë arsye specifike për këtë kërkesës.

Parashtruesja e kërkesës në thelb pretendon se në këtë çështje ekziston një vendim përfundimtar, përkatësisht Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në

Prizren P.nr.462/10, i 21 dhjetorit 2011, i cili ishte bërë përfundimtar më 19 maj 2012, dhe i cili ende nuk është përmbaruar përkundër përpjekjeve të saj të vazhdueshme.

Lidhur me nenin 46 të Kushtetutës, pretendoi se deri të braktisja e pronës së saj ka ardhur për shkak të forcës madhore (vis major), e jo me veprimet e saj me vetë dëshirë. Prej atij momenti ajo ka qenë objektivisht e penguar ta shfrytëzojë pasurinë e saj, dhe pas kalimit të më shumë se 19 vjetëve i është pamundësuar qasje në pasurinë lëndore. Sipas saj, për shkak të punës joefektive dhe joefikase së pari të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, e më pas edhe të gjykatave të rregullta janë krijuar pasojat e dëmshme të cilat ankuesja si pronare e pronës po i vuan. Me këtë, mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtës së pacenueshme të pronës, të garantuar me kornizën ekzistuese të legjislacionit, janë të pafuqishëm që t'ia mundësojnë qasjen në pronë dhe mbrojtje të gëzimit të qetë të pronës.

Gjykata në këtë rast konstatoi se ekzistojnë dy vendime të formës së prerë, respektivisht Vendimi i Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, i 30 prillit 2005, sa i përket të drejtës së shfrytëzimit të pronës që është objekt kontesti si dhe Aktgjykimi P. br.462/10 i Gjykatës Komunale, i 21 dhjetorit 2011, e i cili është bërë i plotfuqishëm më 19 maj 2012 përmes së cilit e urdhëroi të padituri B.M. që ta lirojë pronën e uzurpuar dhe të njëjtën ta kthejë në gjendje të mëparshme, duke i larguar të gjitha punimet të cilat i ka kryer në pronën në fjalë

Gjykata konstatoi se mospërmbarimi i Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore i 30 prillit 2005 dhe Aktgjykimit P. br.462/10 i Gjykatës Komunale, i 21 dhjetorit 2011, si dhe pezullimi i këtij të fundit në procedurë përmbarimore nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren duke e mbyllur procedurën përmbarimore, në rastin e parashtrueses së kërkesës, përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Gjykata gjithashtu konstatoi se pamundësia për të ndërmarrë veprime të mëtejshme ligjore për përmbarimin e Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore të 30 prillit 2005 dhe Aktgjykimit P. br.462/10 të Gjykatës Komunale, të 21 dhjetorit 2011, paraqet gjithashtu shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të KEDNJ-së.

Përveç kësaj, Gjykata konstaton se si rezultat i mospërmbarimit të vendimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm, parashtruesja e kërkesës është privuar pa të drejtë nga prona e saj. Në këtë mënyrë është shkelur edhe e drejta e parashtrueses së kërkesës për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën e saj, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës, dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Në fund, Gjykata konsideron se nuk duhet të merret më tej me pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së, sepse pretendimet dhe kërkesat e tilla janë konsumuar nga konstatimet e Gjykatës për shkelje të neneve 31, 32, 54 dhe 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Gjykata e refuzoi kërkesën e parashtrueses për moszbulim të identitetit, pasi që parashtruesja e kërkesës nuk e kishte specifikuar arsyen lidhur me këtë kërkesë.

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KI86/18

Parashtrues

Slavica Đordević

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CA.nr.2093/2017, të 29 janarit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Slavica Đordević (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës) me vendbanim në Novi Sad, Serbi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [CA.nr. 2093/2017] të 29 janarit 2018.

3. Parashtruesja e kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 26 shkurt 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [CA.nr.2093/2017] të 29 janarit 2018, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e saj

kushtetuese të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); si dhe me nenet përkatëse të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) nenin 6 paragrafi 1 [E drejta për gjykim të drejtë]; neni 13 [E drejta për mjete efektive juridike]; nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ [Mbrojtja e pronës]; nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit], si dhe me nenet përkatëse të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ), respektivisht neni 2, neni 8, neni 10 dhe neni 17.

5. Parashtruesja e kërkesës kërkon që identiteti i saj të mos zbulohet, pa dhënë ndonjë arsye specifike për këtë kërkesë.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 18 qershor 2018, parashtruesja parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi si Gjyqtar raportues. Në të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (Kryesues), Selvete Gërxhaliu- Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani (anëtare).

9. Më 7 shtator 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren që të dorëzonte në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.

10. Në afatin e dhënë nga Gjykata, kjo e fundit nuk ka pranuar dosjen e kërkuar.

11. Më 25 janar 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren që të dorëzonte në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesja e kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.

12. Më 18 mars 2019, Gjykata Themelore në Prizren e dorëzoi fletëkthesën e kërkuar.

13. Më 3 gusht 2020, Gjykata ripërsëriti kërkesën për Gjykatën Themelore në Prizren, që të dorëzonte në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.

14. Më 24 gusht 2020, Gjykata Themelore në Prizren dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.

15. Më 27 gusht 2020, Gjykata e njoftoi palën në procedurë para gjykatave të rregullta, B.M., për regjistrimin e kërkesës duke i ofruar mundësinë që të paraqesë komentet e tij brenda një afati prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të shkresës së Gjykatës.

16. Më 4 shtator 2020, F.M., si përfaqësues i përkohshëm i B.M., dorëzoi në Gjykatë komentet e tij lidhur me rastin, duke bashkëlidhur gjithashtu Aktvendimin [I.br.1241/2012] e Gjykatës Themelore në Prizren të 12 qershorit 2018 si dhe Certifikatën Kadastrale lidhur me pronën kontestuese.

17. Më 17 dhjetor 2020, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen për këtë rast ta shtyjë për një seancë tjetër.

18. Më 3 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

19. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri konstatoi se (i) kërkesa është e pranueshme; dhe se (ii) Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, [CA.br.2093/2017], i 29 janarit 2018, dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren [I.br.1241/12], i 27 shkurtit 2017, nuk janë në përputhshmëri me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6.1 dhe 13 të KEDNJ-së, si dhe nenin 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

(A) Faktet lidhur me vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit të pronës në favor të parashtrueses së kërkesës

20. Më 30 mars 1993, Komuna e Prizrenit përmes Aktvendimit [nr.03/3462/138] kishte vendosur që parashtrueses së kërkesës t'i njihte të drejtën e shfrytëzimit të parcelës ndërtimore nr. 65 C, pjesë e ngastrës kadastrale nr. 7140/1, në sipërfaqe prej 180 m2.

21. Më 8 nëntor 1993, Komuna e Prizrenit përmes Aktvendimit [nr.04/4-351-233] i lejoi parashtrueses së kërkesës ndërtimin e objektit të banimit në parcelën në fjalë.

22. Në vitin 1997 parashtruesja e kërkesës kishte filluar ndërtimin e një objekti banimi në parcelën në fjalë, të cilat punime më vonë ishin ndërprerë si rezultat i luftës në Kosovë.

23. Pas vitit 1999, parcela në fjalë ishte uzurpuar nga B.M. Ky i fundit kishte ndërtuar edhe dy kate të tjera mbi konstruksionin ekzistues të objektit të banimit në ndërtim e sipër që parashtruesja e kërkesës e kishte filluar, por që nuk kishte arritur ta mbaronte.

24. Pas këtyre zhvillimeve, parashtruesja e kërkesës në cilësi të pronares kishte paraqitur kërkesë në Komisionin për Çështje Pronësore Banesore (në tekstin e mëtejmë: KÇPB) për kthimin e pronës kontestuese në posedim të saj.

25. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton që më 30 prill 2005, KÇPB aprovoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës duke vërtetuar të drejtën e saj për shfrytëzimin e pronës dhe se prona lëndore në fjalë duhet t'i kthehet asaj në posedim, në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

26. Kundër vendimit të lartcekur të KÇPB, B.M. parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit).

27. Më 16 dhjetor 2005, Kolegji i Apelit refuzoi ankesën e B.M. dhe vërtetoi vendimin e shkallës së parë KÇPB. (*Sqarim i Gjykatës: të dy vendimet e cekura të KÇPB nuk gjenden në dosjen e plotë të rastit të dorëzuar nga Gjykata Themelore. Faktet lidhur me këto vendime janë nxjerrë nga vendimet e tjera në dosje të cilat citojnë përmbajtjen e tyre*).

28. Rrjedhimisht, bazuar në procedurat e lartcekura, rezulton që në të dy shkallët pranë KÇPB: (i) parashtrueses të kërkesës iu konfirmua/njoh e drejta e shfrytëyzmit të ngastrës kadastrale e cila është objekt kryesor i kontestit dhe rastit në fjalë; dhe se (ii) pala e interesuar B.M. u obligua që ta lirojë pronën në fjalë në dobi të parashtrueses së kërkesës.

(B) Faktet lidhur me kthimin e pronës në posedim të parashtrueses së kërkesës, pas vërtetimit se B.M. e kishte uzurpuar atë në mënyrë të kundërligjshme

29. Në një datë të paspecifikuar, pasi që B.M. nuk e kishte liruar objektin kontestues në fjalë, përkundër vendimeve përfundimtare të KÇPB në shkallë të parë dhe të dytë, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prizren (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale), me kërkesë që prona lëndore t'i kthehet në riposedim.

30. Më 22 tetor 2009, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [P.nr.422/05], hodhi poshtë padinë e parashtrueses së kërkesës si të papranueshme, me arsyetimin se vendimmarrja për një çështje për të cilën KÇPB veçse kishte marrë vendim ishte jashtë kompetencës së saj lëndore.

31. Kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Komunale parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut).

32. Më 19 shkurt 2010, Gjykata e Qarkut prishi Aktvendimin e Gjykatës Komunale [P.nr.422/05] të 22 tetorit 2009, dhe çështjen e ktheu në rigjykim në shkallë të parë.

33. Më 21 dhjetor 2011, Gjykata Komunale, tashmë në procedurë rivendosjeje, nxori Aktgjykimin [P.br.462/10] përmes të cilit e urdhëroi të paditurin B.M. që ta lirojë pronën e uzurpuar dhe të njëjtën ta kthej në gjendje të mëparshme, duke i larguar të gjitha punimet të cilat i ka kryer në pronën në fjalë. Për më tepër, Gjykata Themelore në Prizren përmes këtij Aktgjykimi: (i) urdhëroi B.M.-në që të paguajë shumën prej 400 euro në lidhje me shpenzimet e procedurës gjyqësore; ndërkaq që (ii) refuzoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës për kompensim të dëmit të shkaktuar në shumë prej 150.000,00 euro.

34. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale, B.M. paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

35. Më 18 maj 2012, Gjykata e Qarkut përmes Aktgjykimit [Ac.nr.114/12] e refuzoi si të pabazuar ankesën e B.M. dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale [P.br.462/10] të 21 dhjetorit 2011. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata e Qarkut konsideroi se i njëjti ishte i drejtë dhe se gjendja faktike ishte vërtetuar në mënyrë të plotë.

36. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut, B.M. ushtroi revizion në Gjykatën Supreme.

37. Më 9 korrik 2013, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev.nr.247/2012], e refuzoi si të pabazuar revizionin e B.M.

38. Rrjedhimisht, bazuar në faktet e lartcekura, rezulton që padia e parashtrueses së kërkesës e paraqitur kundër të padituri B.M., i cili kishte uzurpuar pronën e saj që nga viti 1999, ishte aprovuar dhe kishte rezultuar e suksesshme pranë gjykatave të rregullta. Të tri gjykatat, ajo Komunale, e Qarkut dhe Supreme, konfirmuan që: (i) parashtruesja e kërkesës gëzon të drejtën e shfrytëzimit të pronës/ ngastrës kadastrale që ishte objekt kontesti; (ii) i padituri B.M. duhet ta lirojë pronën e uzurpuar; dhe se (iii) i padituri B.M. duhet ta kthejë pronën që është objekt kontesti në gjendje të mëparshme, respektivisht në gjendjen e para mbi-ndërtimit të dy kateve shtesë nga B.M.

(C) Përmbledhja e fakteve lidhur me procedurën e përmbarimit të iniciuar nga parashtruesja e kërkesës me qëllim të ekzekutimit të vendimeve të lartcekura që ishin në favor të saj

39. Më 3 korrik 2012, (pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut dhe para vendimmarrjes lidhur me revizionin pranë Gjykatës Supreme), parashtruesja e kërkesës paraqiti në Gjykatën Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) propozimin për përmbarim të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale [P.br.462/10], të 21 dhjetorit 2011, përmes së cilit asaj iu kishte konfirmuar e drejta e shfrytëzimit të pronës në fjalë dhe B.M. ishte urdhëruar që t'ia lirojë pronën dhe të njëjtën ta kthejë në gjendje të mëparshme.

40. Më 5 shkurt 2013, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [I.br.1241/12] lejoi përmbarimin e Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale.

41. Në një datë të paspecifikuar, B.M. paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore.

42. Më 8 prill 2013, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [CA.nr.3817/2013] e refuzoi si të pabazuar ankesën e B.M., duke e vlerësuar si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin për përmbarim të gjykatës së shkallës së parë.

43. Lidhur me përmbarimin e Aktgjykimit [P.br.462/10] të Gjykatës Komunale në Prizren, të 21 dhjetorit 2011, për kthimin e pronës në gjendje të mëparshme dhe rrënimin e objektit të ndërtuar në pronën e huaj fillimisht ishte angazhuar Kompania PTP "Mali Princ" dhe më pas Kompania NN "Shehu". Shuma e caktuar për kryerjen e punimeve, respektivisht kthimin e pronës në gjendjen e mëparshme, që do të duhej të rezultonte me rrënimin e objektit të ndërtuar ishte përcaktuar në vlerë prej 19.495,42 euro.

44. Më 23 tetor 2014, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Themelore në Prizren për: (i) lirim nga pagesa e shpenzimeve të taksave gjyqësore; si dhe, (ii) lirim nga pagesa e shpenzimeve të procedurës përmbarimore (19.495,42 euro). Ajo arsyetoi se për shkak të gjendjes së rëndë financiare, nuk kishte asnjë mundësi që të bëjë pagesën e shumës së kërkuar për të kthyer pronën e saj në gjendje fillestare.

45. Më 28 gusht 2014, Gjykata Themelore në Prizren përmes Vendimit [I.br.1241/12] vendosi për dy kërkesat e parashtrueses së kërkesës. Sa i përket kërkesës për (i) lirim nga pagesa e shpenzimeve të taksave gjyqësore, Gjykata Themelore në Prizren ia miratoi këtë kërkesë dhe e liroi atë nga shpenzimet e taksave gjyqësore, ndërsa, sa i përket kërkesës për (ii) lirim nga pagesa e shpenzimeve të procedurës përmbarimore, Gjykata Themelore në Prizren ia refuzoi atë kërkesë si të pabazuar.

46. Vendimin e saj përkitazi me këto dy kërkesa, Gjykata Themelore në Prizren e arsyetoi me sa vijon: "*sipas propozimit të kreditorit* [parashtrueses së kërkesës]*, në kuptim të nenit 292 të LPP, kujdestari i debitorit përmbarues iu është urdhëruar që tek departamenti i depozitës të kësaj gjykate, të depozitojë shumën prej 19.495.42 euro e domosdoshme për shpenzimet që kanë lindur gjatë ekzekutimit të punëve përmbarimore [...] Megjithatë, deri më tani pala debitori nuk e ka përmbushur depozitën e domosdoshëm ashtu që firma e lartcekur i ka ndërprerë punimet përmbarimore*. [...] *Duke marr parasysh se pala debitorë nuk i ka deponuar shumat e caktuara të parave e domosdoshme për të i ekzekutuar punët, është rregull që paraprakisht-në paradhënie që ato shpenzime të i paguaj kreditori, prandaj gjykata e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e kreditorit për të e liruar nga pagesa e shpenzimeve për ekzekutim, deri sa ka miratuar si të bazuar kërkesës lidhur me lirimin e shpenzimeve gjyqësore - taksa gjyqësore, për faktin se kreditori është pensionist dhe nuk posedon pasuri të paluajtshme*".

47. Parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Vendimit [I.br.1241/12] të Gjykatës Themelore në Prizren, të 28 gushtit 2014, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike, aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

48. Më 9 mars 2014, Gjykata e Apelit përmes Vendimit [CA.br.4210/2014], kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe kishte vërtetuar Vendimin [I.br.1241/12] e Gjykatës Themelore në Prizren, të 28 gushtit 2014.

49. Më 9 shtator 2014, Gjykata Themelore në Prizren, në procedurën e përmbarimit duke vendosur lidhur me deponimin e mjeteve financiare në "*depozitin qytetar të kësaj gjykate*", përmes Vendimit [I.br.1241/12], kishte urdhëruar parashtruesen e kërkesës që në afat kohor prej 15 ditësh, të deponoj shumën prej 19.495,42 euro në emër të shpenzimeve të ekzekutimit- shembjes së objektit. Më tutje në Vendim shtohet se "*Lidhur me atë se kush duhet të i paguajë shpenzimet e procedurës lidhur me procedurën përmbaruese e definon edhe neni 13 paragrafi 1 i LPP e që është Shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin e kryerjen e përmbarimit paraprakisht i paguan kreditori [...]*".

50. Më 31 maj 2015, Gjykata Themelore, përmes Vendimit [I.br. 1241/12], pasi që B.M. kishte ndërruar jetë, kishte caktuar si përfaqësues të përkohshëm në cilësi të debitorit përmbarues të birin e tij F.M. [*Sqarim i Gjykatës*: *edhe komentet në gjykata lidhur me këtë rast janë dorëzuar nga F.M., si përfaqësues i përkohshëm i B.M.].*

51. Më 3 shtator 2015, Gjykata Themelore, përmes Vendimit [I.br. 1241/12] urdhëroi F.M.-në që t'ia paguajë parashtrueses së kërkesës shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 400 E (katërqind eurove).

(D) Faktet lidhur me shqiptimin e gjobave nga gjykatat e rregullta ndaj F.M.-së për moszbatim të urdhërave të gjykatave të rregullta

52. Në pamundësi të ekzekutimit të Aktgjykimeve në favorin e saj, për shkak të refuzimit të F.M. për t'i përmbushur obligimet e tij që rrjedhin nga vendimet e gjykatave të rregullta të elaboruara më lart, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur një tjetër propozim në Gjykatën Themelore, përmes së cilit kishte kërkuar që të urdhërohet

F.M. të deklarojë pasurinë e tij të luajtshme dhe të paluajtshme para gjykatës.

53. Më 18 janar 2016, Gjykata Themelore përmes Vendimit [I.br. 1241/12] urdhëroi F.M. që brenda 7 (shtatë) ditëve të paraqesë të dhënat e plota lidhur me pasurinë e tij të luajtshme dhe të paluajtshme, duke theksuar se në të kundërtën Gjykata Themelore do t'i shqiptoj dënim në kuptim të nenit 15 dhe 16 të LPP-së.

54. Më 18 janar 2016, Gjykata Themelore përmes Vendimit [I.br. 1241/12], kishte urdhëruar Administratën për Gjeodezi dhe Kadastër - Shërbimi i Kadastrës së Palujtshmërisë të Komunës së Prizrenit, që brenda 7 (shtatë) ditëve të paraqiste të dhëna të plota lidhur me pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të F.M.-së, duke theksuar se në të kundërtën Gjykata Themelore do t'i shqiptoj gjoba në kuptim të nenit 15 dhe 16 të LPP-së (Ligji për Procedurën Përmbarimore).

55. Më 16 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prizren, përmes Aktvendimit [I.br. 1241/12], i kishte shqiptuar gjobë F.M. në lartësi prej 500 euro, për shkak të mosrespektimit të Vendimit [I.br. 1241/12] të po kësaj gjykate, të 18 janarit 2016, lidhur me obligimin që të tregojë të gjitha të dhënat për pronën e tyre të luajtshme dhe të paluajtshme.

56. Më 16 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prizren përmes Aktvendimin [I.br. 1241/12], kishte urdhëruar F.M. që në afat prej 7 (shtatë) ditësh të depozitojë në xhirollogarinë e gjykatës shumën prej 19.495,42 euro në emër të shpenzimeve të cilat do të shkaktoheshin rreth prishjes së objektit, lidhur me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren P.br.462/2010, të 21 dhjetorit 2012. Më tutje në arsyetim theksohet: "*duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit të dhëna në aktvendim GZH.Nr. 1252/12 të 30.09.2015 dhe duke pasur parasysh që në kuptim të nenit 292 të LPP-së qëndron detyrimi i debitorit që të deponoj shumën e caktuar të të hollave të nevojshme për kryerjen e veprimeve përmbarimore[...] kjo gjykatë ka urdhëruar që F.M, kujdestar dhe përfaqësues i përkohshëm i debitorit të përmbarimit, në afatin e caktuar të deponojë mjetet e caktuara [...]*".

57. Në një datë të paspecifikuar F.M., kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimeve me të njëjtin numër [I.br.1241/12] të Gjykatës Themelore të 16 shkurtit 2016, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore.

58. Më 15 shtator 2016, Gjykata Supreme, me Aktvendimin [Gzh.nr.2473/16] kishte hedhur poshtë si të paafatshme ankesën me arsyetimin se e njëjta është dorëzuar pas afatit prej 7 (shtatë) ditësh të përcaktuar me ligj.

59. Më 27 shkurt 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [I.br. 1241/12], i kishte shqiptuar gjobë në të holla në shumë prej 1000 (një mijë euro) F.M. për shkak të mosrespektimit të Aktvendimit të Gjykatës Themelore I.br.1241/12 të 5 shkurtit 2013, për lejimin e ekzekutimit të dokumentit përmbarues - Aktgjykimin [P.br. 462/10] e 21 dhjetorit 2011, të Gjykatës Komunale në Prizren.

60. Më 6 prill 2017, F.M. paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit I.br.1241/12, të Gjykatës Themelore në Prizren duke pretenduar shkelje themelore të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

(E) Faktet rreth procedurës e cila si rrjedhojë ka pezullimin e procedurës përmbarimore për ekzekutimin e vendimeve që ishin në favor të parashtrueses së kërkesës

61. Në një datë të pacaktuar, Gjykata Themelore kishte kërkuar dhënien e mendimit juridik nga Gjykata Supreme, se si duhet vepruar kur debitori në lëndën përmbarimore, në kuptim të nenit 292 të LPP është urdhëruar që të depozitojë shumën e caktuar të mjeteve për pagimin e shpenzimeve që do të shkaktohen me kryerjen e veprimit nga personi tjetër apo nga vet kreditori, nuk e kryen depozitimin e këtyre mjeteve.

62. Më 1 shkurt 2016, Gjykata Supreme, në opinionin juridik të saj kishte theksuar "*neni 13 paragrafi 1 i LPP-së (e cila është normë standarde që rregullon këtë çështje) jep përgjigje të mjaftueshme në të cilën thuhet se "shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbarimit paraprakisht paguan kreditori", ndërsa në kuptim të kësaj dispozite juridike, përkatësisht paragrafi 4, debitori detyrohet që kreditorit më vonë t'ia paguajë të gjitha shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës së përmbarimit. Nga kjo që u tha rezulton që në pajtim me këtë dispozitë juridike, procedura e përmbarimit duhet të vazhdojë ashtu që, kreditori do të depozitojë shumën e caktuar të nevojshme për pagimin e shpenzimeve që do të shkaktohen me kryerjen e veprimit nga personi tjetër, në rast se debitori nuk depoziton mjetet financiare të lartpërmendura, shumë e cila, më vonë do ti kompensohet kreditorit nga ana e debitorit*".

63. Më 27 shkurt 2017, Gjykata Themelore në Prizren, përmes Vendimit [I.br.1241/12] kishte theksuar si në vijim:

> "I. *Urdhërohet kreditori përmbarues* [parashtruesja e kërkesës] *[...] që brenda periudhës kohore prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi, të bëjë pagesën e shumës prej 19.000 E (nëntëmbëdhjetë mijë euro) në emër të shpenzimeve të ekzekutimit, e caktuar sipas çmimit të punëtorit të autorizuar të personit të tretë NN "Shehu" me seli në Prizren, e të cilat shpenzime do të lindin nga kryerja e veprimtarive të kthimit në gjendjen fillestare të pronës së paluajtshme, siç është shembja e punëve ndërtimore, arbitrare të kryera nga debitori përmbarues B.M. nga Prizreni* [...].
> II. *nëse pala kreditore nuk i paguan shpenzimet e ekzekutimit në shumën e caktuar brena periudhës së paraparë si në dispozitivin I të këtij vendimi, gjykata si organ përmbarues do të ndalojë ekzekutimin në këtë çështje juridike ekzekutive I.br.1241/12, dhe nuk do zbatoj veprimin përmbarues të përshkruar si në dispozitivin I të këtij vendimi*". Në Aktgjykim theksohet "*Gjykata pas ekzaminimit të dosjeve të rastit e posaçërisht lidhur me mendimin ligjor të Gjykatës Supreme, ka ardhur në përfundim se kreditori përmbarues* [parashtruesja e kërkesës] *[..] detyrimisht duhet të deponoj shumën e caktuar më lart të parave, në emër të zbatimit të veprimeve ekzekutuese për shembjen e objektit kontestues* [...] *Gjykata i ka ndërmarr edhe veprimet tjera përmbaruese duke gjetur xhirollogaritë bankare dhe mjeteve financiar të debitorit në këto xhirollogari dhe atë në cilësi të personit fizik dhe atij juridik.*"

64. Më 11 prill 2017, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Vendimit I.br.1241/12 të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

65. Më 29 janar 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [CA.nr.2093/2017] refuzoi si të pabazë ankesën dhe vërtetoi Vendimin [I.br.1241/12] e 27 shkurtit 2017 të Gjykatës Themelore. Në këtë Aktvendim shtohet se: "*kreditori* [parashtruesja e kërkesës] *është liruar nga pagesa e taksave gjyqësore, derisa kërkesa e* [parashtrueses së kërkesës që] *të lirohet nga të gjitha shpenzimet procedurale me paragrafin I të aktvendimit përkatës është refuzuar si e pabazë* [...] *Kreditori deri në përfundim të kësaj çështjeje në gjykatën e shkallës së parë e as në procedurën sipas ankesës nuk ka*

provuar se obligimet paraprake të shpenzimeve procedurale për zbatimin e përmbarimit në këtë çështje përmbarimore nëse duhet të paguaj debitori ekzekutiv, ndryshe nga baza ligjore e nenit 13 të LPP dhe mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës se shpenzimet përkatëse në këtë çështje përmbarimore duhet t'i kryej kreditori, dhe pas përfundimit të përmbarimit, e sipas bazës ligjore të paragrafit 4 të nenit 13 të ligjit të njëjtë, debitori ka për obligim të kompensojë kreditorin".

66. Më 12 qershor 2018, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [I.br.1241/2012] pezulloi përmbarimin në këtë çështje juridike. Në këtë Aktvendim ndër të tjera theksohet "*pala kreditore* [parashtruesja e kërkesës]*, nuk ka vepruar sipas detyrimit të urdhëruar për të si palë kreditore e me përshkrimin e bërë si në aktvendimin e kësaj gjykate, E nr.121/2012 të dt 27.2.2017, për të bërë deponimin e mjeteve gjegjëse monetare* [19,xxx,42 euro] *në emër të shpenzimeve gjegjëse por deri më tani nuk ka bërë deponimin e shumës së lartcekur në të holla në emër të shpenzimeve do të shkaktoheshin me kryerjen e veprimit të përmbarimit- kthimi në gjendje të mëparshme të tokës si dhe të largohen të gjitha punimet ndërtimore të kryera në mënyrë arbitrare nga debitori i përmbarimit, [B.M.] [...] kjo gjykatë me arsyet e cekura më lartë e bëri pezullimin e përmbarimit në këtë çështje juridike*".

67. Më 8 gusht 2018, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit [I.br.1241/2012] të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

68. Më 21 janar 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit Ac.nr. 4328/2018, refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [I.br.1241/2012] e Gjykatës Themelore, të 12 qershorit 2018. Më tutje në këtë Aktvendim theksohet se: "*në situatën faktike në pajtim me nenin 13 pika 1 të LPP-së shpenzimet lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbarimit paraprakisht i paguan kreditori [..] Organi përmbarues do ta pezulloj përmbarimin po që se nuk paguhen shpenzimet brena afatit të tillë*".

Pretendimet e parashtrueses

69. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me: nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 32 [E Drejta për Mjete

Juridike]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenet përkatëse të KEDNJ, respektivisht nenin 6 paragrafi 1 i [E drejta për gjykim të drejtë]; nenin 13 [E drejta për mjete efektive juridike]; nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ [Mbrojtja e pronës]; nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit], si dhe me nenet 2, 8, 10 dhe 17 të DUDNJ.

70. Lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës thekson se në këtë çështje ekziston një vendim përfundimtar, përkatësisht Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren P.br.462/10, i 21 dhjetorit 2011, i cili ishte bërë përfundimtar më 19 maj 2012, dhe i cili ende nuk është përmbaruar përkundër përpjekjeve të saj të vazhdueshme.

71. Parashtruesja e kërkesës pretendon se në rastin e saj ka tejzgjatje të procedurave, përkundër asaj se sipas saj natyra e përmbarimit është e natyrës urgjente, dhe se ajo edhe pas gati 20 vjet përpjekjesh nuk po mund të gëzojë pronën e saj.

72. Në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës pretendon se "*Debitori ekzekutiv* [B.M e tashmë F.M.] *nuk është shfrytëzues në mirëbesim i pronës lëndore [..] mos ndërmarrja e veprimeve juridike dhe faktike që i ka në dispozicion me ligjin nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren si dhe nga ana e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, se të gjitha përpjekjet e saja për ekzekutimin e aktgjykimit të plotfuqishëm gjyqësor P. Nr. 462/ 10, kanë mbetur të pasuksesshme dhe kanë krijuar situatën e pasigurisë juridike*".

73. Po ashtu, parashtruesja e kërkesë ka theksuar se *"[ë]shtë e qartë se nuk ekziston përkushtimi i organit kompetent që në mënyrë efikase të zbatojë procedurën e ekzekutimit të aktgjykimit të lartpërmendur. Me këtë, inkonsekuenca në zbatimin e aktgjykimit të lartpërmendur sjellë deri te mosrespektimi i parimeve themelore të sundimit të ligjit, shtetit ligjor dhe standardeve ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut."* Në këtë aspekt, parashtruesja i referohet *"aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lëndën KI – 104/ 10 të dt. 13.12.2011, me të cilën në fq. 77 është konstatuar obligimi dhe përgjegjësia pozitive që në rendin juridik të organizohen mekanizmat për ekzekutimin e vendimeve, të cilët janë efektivë edhe sipas ligjit edhe në praktikë, me të njëjtin të sigurohet zbatimi i vendimeve pa shtyrje [...]"*.

74. Parashtruesja e kërkesës më tej thekson se "*Gjykata [Themelore] ishte jo konsekuent në zbatimin e autorizimeve ligjore të cilat pasqyrohen si në vijim: Mungesë e veprimit të shpejtë në procedurën e*

ekzekutimit, mos zbatimi i të gjitha masave në dispozicion të konstatuara me dispozita ligjore".

75. Parashtruesja e kërkesës thekson se me dy vendimet e fundit në bazë të të cilave është pezulluar procedura përmbarimore "*nuk kanë përmbajtur arsyetime të qarta dhe eksplicite, se në bazë të cilave fakte dhe bazave ligjore i bazojnë pretendimet e tyre për këtë lloj të vendimit. Arsyetimi i gjithmbarshëm bazohet ekskluzivisht në mendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndën GJA nr. 63/ 2016 të dt. 16.02.2016, ku gjykata e lartpërmendur është e mendimit se mjetet duhet ti paguaj si paradhënie kreditori ekzekutiv, i cili në rrjedhën e mëtutjeshme të procedurës do t'i rimbursojë të gjitha shpenzimet e procedurës ekzekutive nga debitori ekzekutiv [...] qëndrimet e paarsyetuara të cilat janë me rëndësi thelbësore për rezultatin e procedurës ekzekutive nga ana e gjykatës në rastin konkret, tregojnë për arbitraritet në veprim dhe bazueshmëri të pamjaftueshme të qëndrimeve dhe vendimeve të marra në këtë mënyrë".*

76. Parashtruesja e kërkesës thekson se "*në rastin konkret palët në kontest nuk janë në pozitë të njëjtë, dhe me këtë vihet në pyetje parimi i cili ishte dashur të vendosë legjitimitetin e respektimit të vendimeve gjyqësore, nga ana e uzurpatorit dhe ndërtuesit të pandershëm në pronën e huaj, në rastin konkret ky është debitori ekzekutiv [...] veprimet e gjertanishme të organeve gjyqësore nuk kanë ofruar garanci të mjaftueshme në kuptimin e paanshmërisë dhe për këtë shtrohet pyetja se a është gjykata vërtetë pala neutrale në këtë kontest".*

77. Në mbështetje të pretendimeve të saj lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesja i referohet një numri të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, respektivisht rastit *Pecev kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Aktgjykim i 6 nëntorit 2008, *Cvjetić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 26 shkurtit 2004; *Hiro Balani kundër Spanjës*, i 9 dhjetorit 1994; *Ziegler kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 21 shkurtit 2003; dhe *Teteriny kundër Rusisë*, Aktgjykim i 26 shtatorit 1994.

78. Sa i përket shkeljes së nenit 32 të Kushtetutës parashtruesja e kërkesës pretendon se "*Përkundër asaj që ankuesja ka mundur t'i shfrytëzojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, ato kanë mbetur joefikase [...] Kështu që e drejta për mjet efikas juridik në rastin konkret ka mbetur vetëm e drejtë formale në këtë kuptim, ndërsa ekzekutimi i vendimit të plotfuqishëm dhe përmbarimor gjyqësor është praktikisht i pazbatueshëm, sepse ankuesja nuk ka mjete financiare as ta ushqejë*

veten dhe familjen e vet, ndërsa mbi pagesën e paradhënies në shumën siç është precizuar më lartë as që bëhet fjalë".

79. Lidhur me nenin 46 të Kushtetutës pretendon "*Deri te braktisja ka ardhur për shkak të shkeljes së rëndë të sigurisë, pra, forcës madhore* (vis major), *e jo me veprimet e saja me vetë dëshirë. Prej atij momenti ajo ka qenë objektivisht e penguar ta shfrytëzojë pasurinë e saj, dhe pas kalimit të më tepër se 19 vjetëve i është pamundësuar qasje në pasurinë lëndore. Këtë fakt e ka konfirmuar edhe vet debitori ekzekutiv gjatë dhënies së deklaratës në Gjykatë se pronën lëndore po e shfrytëzon prej vitit 1999. Për shkak të punës joefektive dhe joefikase së pari të HPD-së, e më pas edhe të gjykatave të rregullta janë krijuar pasojat e dëmshme të cilat ankuesja si pronare e pronës po i vuan. Me këtë mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtës së pacenueshme të pronës, të garantuar me kornizën ekzistuese të legjislacionit janë të pafuqishëm, që t'ia mundësojnë qasje në pronë dhe mbrojtje të gëzimit të qetë të pronës".*

80. Parashtruesja e kërkesës pohon se B.M. nuk është shfrytëzues në mirëbesim i pronës dhe në mënyrë të paligjshme e ka ndërtuar objektin në pronën kontestuese. Parashtruesja e kërkesës më tutje lidhur me shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës i referohet parimit "'*suprerficies solo credit', me të cilin është cekuar se gjithë çfarë është në lidhje të fortë fizike me tokën e cila i takon pronarit dhe në rast të konflikt të interesit të dy personave favorizohet pronari*".

81. Parashtruesja e kërkesë po ashtu i referohet edhe nenit 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit] të Kushtetutës duke theksuar se "*Republika e Kosovës promovon dhe lehtëson kthimin e sigurtë dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre".*

82. Në fund parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të urdhërojë ekzekutim urgjent të Aktgjykimit [P.br.462/10] të Gjykatës Komunale duke kërkuar që shpenzimet e përmbarimit të ngarkohen në llogari të debitorit ekzekutiv apo në buxhetin shtetëror. Parashtruesja e kërkesës më tutje kërkon që Gjykata ta shpallë të pavlefshëm, Aktvendimin [CA.nr. 2093/17] e Gjykatës së Apelit.

Komentet e palës së interesuar F.M. – në cilësi të përfaqësuesit të përkohshëm të B.M. (i cili kishte qenë palë para gjykatave të rregullta)

83. Lidhur me kërkesën në fjalë, përfaqësuesi i përkohshëm i B.M, F.M., dorëzoi komente në Gjykatë, pas njoftimit të kësaj të fundit. Në thelb, ai kundërshtoi në tërësi të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës.

84. Fillimisht në komentet e tij, përfaqësuesi i përkohshëm thekson se në librat e tokës, Komuna e Prizrenit figuron si pronare e patundshmërisë që është kontestuese, duke pretenduar se e njëjta është dashur që të përfshihet si palë në procedurë. Lidhur me këtë .F.M. thekson " *sa i përket lejes së ndërtimit në emër të Slavica Gjorgjeviq e njëjta nga ana e Komunës është anuluar sepse në afatin e caktuar prej 3 viteve nuk ka filluar me ndërtimin e objektit të parapara me rregulloret e komunës".* Lidhur me këtë tutje pretendon *"e njëjta nuk është pronare e parcelës kontestuese, por Komuna e Prizrenit, pra e njëjta nuk e ka pasur legjitimacionin aktiv në asnjërën procedurë të zhvilluar deri më tani".*

85. Pas një përshkrimi të gjendjes faktike, F.M. pretendon se kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme, duke theksuar si në vijim:

- *Në rend të parë kërkuesja nuk i ka shtjerë të gjitha mjetet juridike të pranuara me ligj. Nuk ka bërë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ashtu siç është paraparë sipas dispozitës 113.7 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 39 të rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese;*
- [Parashtruesja] *ka bërë tejkalimin e afatit për parashtrimin e kërkesës siç është paraparë me dispozitën e nenit 49 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese;*
- *Për shkak të inkompetencës së gjykatës bazuar në kërkesat e parashtrueses nga pasqyra e zgjidhjes së kërkuar;*
- *Mungesës së fakteve provuese lidhur me kërkesat e parashtruara.*

86. Në komentet e tij drejtuar Gjykatës, lidhur me pretendimet e parashtrueses së kërkesës tutje shton se "*të gjitha të drejta i janë respektuar deri në momentin kur i është kërkuar të deponoj shumën prej 19.000€ sipas aktvendimit E.nr. 1241/12 të datës 27.02.2017, e cila procedurë vlen për të gjithë pjesëmarrësit ashtu siç parashihet sipas nenit 13 të Ligjit për Procedurën Përmbaruese. Gjykata nuk ka të drejtë që të detyrojë ndonjë individ apo ndërmarrje që ë bëj përmbarimorin pa pagesë ose shpenzimet të faturoj ndonjë institucioni ose në buxhetin e shtetit. Ndaj këtij aktvendimi parashtruesja e kërkesës është udhëzuar në ankesë të cilën edhe e ka*

shfrytëzuar dhe për këtë ka vendos gjykata e Apelit [...] ndaj këtij aktvendimi parashtruesja "*sipas së drejtës sonë ka pasur të drejtë që të parashtroj mjetin e jashtëzakonshëm të cilin nuk e ka shfrytëzua. Andaj duke pasur parasysh se e njëjta nuk e ka shtjerë të gjitha mjetet juridike nuk i plotëson kushtet për shqyrtim*".

87. Lidhur me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për kompensim material, përfaqësuesi i përkohshëm pretendon se kjo kërkesë e parashtrueses së kërkesës "*është jashtë kompetencës së Gjykatës kushtetuese*".

88. Krejt në fund kërkon nga Gjykata që kërkesa e parashtrueses së kërkesës të shpallet e papranueshme, duke theksuar se nuk kemi të bëjmë me shkeljen e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë.

Dispozitat përkatëse ligjore

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 13
Shpenzimet e përmbarimit

1. Shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbarimit paraprakisht i paguan kreditori.

2. Shpenzimet nga paragrafi 1. i këtij neni, propozuesi i përmbarimit ka për detyrë t'i parapaguaj brenda afatit të caktuar nga organi përmbarues. Organi përmbarues do ta pezulloj përmbarimin po qe se nuk parapaguhen shpenzimet brenda afatit të tillë. Po qe se brenda afatit të dhënë nga organi përmbarues nuk parapaguhen shpenzimet për kryerjen e një veprimi konkret, atëherë nuk do të kryhet vetëm veprimi i tillë.

3. Shpenzimet e procedurës së filluar nga Gjykata sipas detyrës zyrtare, paraprakisht i përballon vetë Gjykata nga mjetet financiare të buxhetit të saj.

4. Debitori ka për detyrë që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet procedurale dhe të gjitha shpenzimet tjera të shkaktuara gjatë procedurës së përmbarimit.

5. Kreditori duhet t'ia kompensojë debitorit shpenzimet e shkaktuara pa nevojë të justifikueshme.

6. Për kërkesën për pagimin e shpenzimeve procedurale organi përmbarues vendos njëkohësisht me vendimin për përmbarim po në këtë procedurë sipas propozimit të palës, duke e caktuar përmbarimin me qëllim të realizimit të tij.

Neni 15
Gjobat në procedurën përmbarimore

1. Gjobat e parapara nga ky nen mund të shqiptohen, me vendim të Gjykatës, për çdo veprim apo mosveprim me të cilat shkelen dispozitat e këtij ligji apo të vendimit të organit përmbarues në pajtim me këtë ligj. Këto gjoba mund të shqiptohen nga Gjykata sipas detyrës zyrtare, si dhe në bazë të propozimit të arsyetuar të përmbaruesit privat nëse në procedurën që zhvillohet pranë përmbaruesit privat janë plotësuar kushtet për shqiptimin e gjobës.

2. Gjobat mund të shqiptohen kundër personave fizik në procedurën përmbarimore në shumë prej njëqind (100) gjer në njëmijë (1.000) Euro, përderisa për personat juridik në shumë prej njëmijë (1.000) gjer në dhjetë mijë (10.000) Euro.
3. Gjoba në të holla në shumë prej pesëqind (500) deri dymijë e pesëqind (2.500) Euro mund t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës të personit juridik.

4. Gjoba në të holla nga paragrafi 2. i këtij neni, mund të shqiptohet në mënyrë të përsëritur, po qe se debitori nuk vepron sipas urdhrit të përsëritur të Gjykatës apo përmbaruesit privat apo vazhdon të veprojë në kundërshtim me këtë urdhër.

5. Para shqiptimit të gjobës në të holla, Gjykata ia mundëson palës ndaj së cilës është shqiptuar gjoba që të deklarohet, dhe kur konsiderohet e nevojshme nga Gjykata, ajo mund të caktojë seancë me qëllim të marrjes së provave.

6. Gjobën në të holla e shqipton Gjykata duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, e sidomos mjetet ekonomike të palës dhe rëndësinë e veprimit që konsiderohet se ka pasur për detyre ta kryej pala. Me aktvendimin për gjobitjen, caktohet edhe afati për pagimin e shumës së të hollave që e përbënë gjobën.

7. Personi i gjobitur mund të ankohet kundër aktvendimit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, nga dita kur i është dorëzuar.

8. Personi i gjobitur duhet t'i paguaj shpenzimet e krijuara me

shqiptimin dhe përmbarimin e kësaj gjobe.

9. Pas përmbarimit të aktvendimit, gjobën në të holla e realizon organi përmbarues sipas detyrës zyrtare, në dobi të llogarisë rrjedhëse nga e cila financohet Gjykata. Shpenzimet e përmbarimit e ngarkojnë buxhetin e Gjykatës, kurse pagimi i këtyre shpenzimeve që caktohet me anë të konkluzionit, zbatohet në procedurën e realizimit të dhunshëm të gjobës në të holla.

10. Gjoba në të holla mund të shqiptohet dhe zbatohet edhe kundër debitorit dhe personave të tjerë fizik, si dhe kundër personave përgjegjës të personit juridik edhe kur refuzojnë të japin të dhëna për pasurinë e debitorit, si dhe kur me veprimet dhe sjelljet e tyre në kundërshtim me urdhrin e autoritetit përmbarues, ose kur e dëmtojnë apo zvogëlojnë pasurinë e debitorit, apo e pengojnë organin përmbarues në kryerjen e veprimeve përmbarimore.

11. Gjoba në të holla e shqiptuar sipas dispozitave të këtij neni nuk mund të shndërrohet në dënim me burgim.

Neni 16
Gjobat për vonesë të përmbarimit

1. Kur debitori nuk përmbushë brenda afatit të caktuar çfarëdo obligimi monetar apo jo monetar të përcaktuar nga dokumenti përmbarues, sipas detyrës zyrtare, apo me propozim të kreditorit, do të përcaktojë një datë jo më pak se tri (3) ditë pas skadimit të afatit për përmbushje vullnetare nga data, me të cilën fillon llogaritja e gjobës nëse pagesa nuk është realizuar gjer në datën e caktuar.

2. Gjobat për çdo ditë të vonesës do të jenë mbi pesë (5) euro por jo më lartë se pesëdhjetë (50) euro për personat fizik, dhe mbi pesëdhjetë (50) euro por jo më tepër se pesëqind (500) euro për personat juridik. Gjobat do të shtohen për çdo ditë apo periudhë tjetër të vonesës, në pajtim me rregullat e Ligjit për Detyrimet, që nga dita e skadimit të afatit për përmbushjen e obligimeve e gjer sa të arrihet kjo përmbushje.

Neni 292
Detyrimi i veprimit që mund të kryhet nga çdokush

1. Përmbarimi për realizimin e detyrimit për veprim të cilin mund ta kryej çdokush, zbatohet ashtu që organi përmbarues e

autorizon kreditorin që me shpenzime të debitorit t'ia besoj ndonjë personi tjetër kryerjen e veprimit të tillë apo që vetë ta kryejë atë veprim.

2. Në propozimin për përmbarim, kërkuesi i përmbarimit mund të propozojë që organi përmbarues me aktvendim apo urdhër për përmbarim t'ia urdhërojë debitorin që më parë ta depozitoj në Gjykatë shumën e caktuar të nevojshme për pagimin e shpenzimeve që do të shkaktohen me kryerjen e veprimit nga personi tjetër, apo nga vetë kreditori. Sasinë e shumës së depozituar organi përmbarues e cakton sipas vlerësimit të lirë, duke marrë parasysh sipas mundësisë çmimoren e personit të autorizuar për kryerjen e veprimit të tillë, të cilën propozimit për përmbarim ia bashkangjetë kreditori.

3. Aktvendimin ose urdhrin definitiv për sasinë e shpenzimeve nga paragrafi 2. i këtij neni, organi përmbarues e jep me propozimin e kërkuesit të përmbarimit, respektivisht të debitorit, pasi të jetë kryer veprimi.

4. Në qoftë se më vonë konstatohet se në bazë të aktvendimit ose urdhrit nga paragrafi 2. i këtij neni, janë marrë nga debitori më tepër mjete se që ka qenë nevoja për mbulimin e shpenzimeve për kryerjen e veprimit dhe të shpenzimeve të procedurës përmbarimore, atëherë organi përmbarues do ta kthejë dallimin nëse ka mjete të marra nga debitori, respektivisht do t'i urdhërojë kreditorit që brenda afatit të caktuar ta kthejë dallimin e tillë, po qe se atij i është lanë në disponim.

5. Në bazë të aktvendimit nga paragrafi 2. i këtij neni, mund të propozohet përmbarimi edhe para se të bëhet i formës së prerë aktvendimi ose urdhri për përmbarimin, kurse në bazë të aktvendimit nga paragrafi 3. i këtij neni, vetëm pasi ai të bëhet i formës së prerë.

Neni 293
Detyrimi i veprimit që mund të kryhet vetëm nga debitori

1. Në qoftë se veprimin e caktuar në dokumentin përmbarues mund ta kryejë vetëm debitori, organi përmbarues me aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin përmbarues do t'ia caktojë debitorit afatin për përmbushjen e detyrimit. Me aktvendimin ose urdhrin për përmbarimin organi përmbarues njëherë i kërcënohet debitorit dhe eventualisht personave

përgjegjës në debitorin që është person juridik, se do të gjobiten sipas nenit 15 dhe 16 të këtij ligji, po qe se brenda afatit të caktuar nuk e përmbushin detyrimin.

2. Në qoftë se debitori brenda afatit që ia ka caktuar organi përmbarues nuk e përmbushë detyrimin, Gjykata sipas propozimit të kërkuesit të përmbarimit, do të veprojë më tutje sipas dispozitave të nenit 15 dhe 16 të këtij ligji.

3. Debitori që e ka përmbushur detyrimin e vet brenda afatit të cilin ia ka lënë organi përmbarues, ka për detyrë që pa vonesë ta njoftojë organin përmbarues për një gjë të tillë, si dhe ta parashtrojë të organi përmbarues mjetin me të cilin në mënyrë të padyshimtë provohet pretendimi i tillë. Provë e këtillë konsiderohet deklarata me shkrim e kërkuesit të përmbarimit të vërtetuar, nga e cila shihet se veprimi i detyruar është kryer, procesverbali i organit përmbarues në të cilin është konstatuar se veprimi i detyruar është kryer, konstatimi dhe mendimi i ekspertit nga i cili shihet se është kryer veprimi, etj. Në të kundërtën do të merret se veprimi nuk është kryer.

4. Në qoftë se veprimi të cilin mund ta kryejë vetëm debitori, nuk varet vetëm nga vullneti i tij (krijimi i veprës artistike muzikore, pamore, letrare, arkitektonike, etj.), atëherë kreditori nuk ka të drejtë ta kërkojë shpërblimin nga paragrafi 1. i këtij neni, por vetëm të drejtën që të kërkojë shpërblimin e dëmit të pësuar.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

89. Në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë këtë kërkesë, së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës të Gjykatës.

90. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

91. Gjithashtu, Gjykata vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë të përcaktuara në nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, si dhe në rregullin 39 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. *Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."*

Neni 49
[Afatet]

"*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor."*

Rregulli 39
Kriteret e pranueshmërisë

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar,
(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar,
(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
[...]

92. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, të parapara me ligj dhe në mungesë të ndonjë mjeti tjetër efektiv në dispozicion, iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, P.br.462/10, të 21 dhjetorit 2011. Parashtruesja e kërkesës ka qartësuar saktësisht të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë shkelur si dhe kërkesën e saj e ka parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor.

93. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar; i ka shteruar të gjitha mjetet juridike; e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor; i ka sqaruar me saktësi shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë; si dhe, i është referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me realizimin e të drejtave të saj për gëzimin dhe posedimin e pronës.

94. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 39 (1) të Rregullores së punës. Rrjedhimisht, kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara në rregullin 39 (3) të Rregullores së punës.

95. Së këndejmi, Gjykata vlerëson se kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar me rregullit 39 (2) të Rregullores së punës dhe se rrjedhimisht e njëjta duhet deklaruar e pranueshme për shqyrtim në merita.

Meritat e kërkesës

96. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta i kanë shkelur asaj të drejtat e garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës; si dhe me nenet përkatëse të KEDNJ, nenin 6 paragrafi 1 [E drejta për gjykim të drejtë]; nenin 13 [E drejta për mjete efektive juridike]; nenin 1 të Protokollit nr.

1 të KEDNJ [Mbrojtja e pronës]; neni 14 [Ndalimi i diskriminimit], si dhe me nenet përkatëse të DUDNJ, respektivisht nenet 2, 8, 10 dhe 17.

97. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës shkeljen e këtyre të drejtave, në thelb, e ndërlidhë me pamundësinë e përmbarimit të Aktgjykimit [P.br. 462/10] të Gjykatës Komunale, të 21 dhjetorit 2011.

98. Para se të shqyrtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës, Gjykata fillimisht do të rikujtojë faktet kryesore të rastit konkret.

99. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton faktin që përmes Vendimit të KÇPB-së, ishte vërtetuar se parashtruesja e kërkesës: (i) gëzon të drejtën e shfrytëzimit të pronës që është objekt kryesor kontesti në këtë rast; dhe se (ii) prona në fjalë duhet t'i kthehet asaj në posedim në një afat prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e Vendimit të KÇPB-së. Duke qenë se prona në fjalë nuk ishte liruar nga personi që e kishte uzurpuar atë, parashtruesja e kërkesës iu kishte drejtuar Gjykatës Komunale në Prizren me kërkesë që prona lëndore t'i kthehet në riposedim. Gjykata Komunale në Prizren, përmes Aktgjykimit [P.br.462/10] kishte aprovuar kërkesën, Aktgjykim ky i cili ishte vërtetuar nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme. Pas përfundimit të procedurave të lartcekura për vërtetim pronësie para gjykatave të rregullta, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur kërkesë për përmbarim të Aktgjykimit [P.br.462/10] të Gjykatës Komunale, të 21 dhjetorit 2011, kërkesë kjo që ishte aprovuar nga Gjykata Themelore dhe nga Gjykata e Apelit. Lidhur me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale ishte caktuar një kompani ndërtimore, e cila kishte caktuar një shumë prej 19.495,42 euro për rrënimin e kateve që B.M. kishte ndërtuar në pronën e parashtrueses së kërkesës, pasi që të njëjtën e kishte uzurpuar në vitin 1999. Parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar që të lirohet nga pagesa e shpenzimeve të përmbarimit duke u thirrur në gjendje të rëndë financiare dhe në pamundësi të pagesës së shumës prej 19.495,42 euro. Kërkesën e tillë, Gjykata Themelore në Prizren e kishte refuzuar me arsyetimin se meqë pala debitore, B.M., nuk e kishte deponuar shumën e domosdoshme të kërkuar për ekzekutimin e punimeve lidhur me rrënimin e objektit, me arsyetimin se është rregull që paraprakisht si paradhënie ato shpenzime t'i paguajë kreditori, respektivisht parashtruesja e kërkesës në rrethana të rastit konkret. Gjykata Themelore kishte kërkuar dhënien e mendimit ligjor nga Gjykata Supreme se si duhet të veprohej në situatën kur debitori nuk paguan shpenzimet, ndërkaq që kreditori nuk ka mundësi financiare t'i paguaj ato. Gjykata Supreme, duke u thirrur në nenin 13 të LPP-së, kishte theksuar se shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen

e përmbarimit paraprakisht paguan kreditori, respektivisht parashtruesja e kërkesës në rastin konkret. Krejt në fund, Gjykata Themelore duke u bazuar kryesisht në mendimin juridik të Gjykatës Supreme obligon parashtruesen e kërkesës që të paguajë paraprakisht shpenzimet përmbarimore, duke theksuar se nëse e njëjta nuk i paguan atëherë Gjykata Themelore do t'a pezullojë procedurën në këtë rast. Ky Vendim i Gjykatës Themelore ishte vërtetuar dhe konsideruar i drejtë edhe nga Gjykata e Apelit. Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës konteston dy vendimet e fundit, përkatësisht të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit që kanë rezultuar me pezullimin e procedurës përmbarimore.

100. Sa i përket pretendimeve për shkelje të neneve 22 dhe 24 të Kushtetutës, nenit 14 të KEDNJ si dhe nenit neni 2, neni 8, neni 10 dhe neni 172 të DUDNJ-së, parashtruesja e kërkesës, përveç që i ka përmendur ato në parashtresën e saj drejtuar Gjykatës, nuk ka ofruar argumente në mbështetje të këtyre shkeljeve të pretenduara.

101. Gjykata në vijim do të fokusohet në shqyrtimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për shkelje të garancive procedurale të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së, si dhe të pretendimeve të saj për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

102. Gjykata thekson që pretendimet thelbësore të parashtrueses së kërkesës që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të garancive procedurale të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, janë interpretuar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, në interpretimin e pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sa i përket respektimit apo mundësisë së ndryshimit të një vendimi të formës së prerë, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

103. Gjykata rikujton nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, që përcakton:

> "1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*"

104. Përveç kësaj, neni 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së, parasheh:

> "1. *Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. [...].*"

105. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj pretendon se ekziston një vendim i formës së prerë, respektivisht Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren P.br.462/10, i 21 dhjetorit 2011, i cili ishte bërë përfundimtar më 19 maj 2012 dhe i cili akoma nuk është përmbaruar. Në Aktgjykimin e lartpërmendur i padituri B.M. ishte urdhëruar ta lirojë pronën e uzurpuar dhe të njëjtën ta kthejë në gjendje të mëparshme duke i larguar të gjitha punimet të cilat i ka kryer në të.

106. Parashtruesja e kërkesës thekson se që nga viti 2012 ka tentuar në vazhdimësi që ta përmbarojë Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Komunale në Prizren P.br.462/10, të 21 dhjetorit 2011, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur deri më tani, dhe për pasojë, asaj edhe më tutje i mohohet e drejta ta gëzojë pronën e saj. Për pasojë, mosekzekutimi i vendimeve në favor të saj pohohet të ketë shkaktuar tejzgjatje të procedurës gjyqësore dhe rrjedhimisht shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

107. Gjithashtu, parashtruesja e kërkesës pohon se me vendimet e fundit, respektivisht Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Themelore [...] me të cilin është pezulluar procedura përmbarimore dhe, i cili është vërtetuar edhe nga Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [...], i është shkelur e drejta e saj për një vendim të arsyetuar, duke pretenduar se në vendimet e lartpërmendura nuk specifikohet baza ligjore në të cilën mbështeten këto vendime.

108. Nga shkresat e lëndës Gjykata vëren se lidhur me këtë rast, më 30 prill 2005, KÇPB, kishte aprovuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës, përmes së cilit është konfirmuar se parashtruesja e kërkesës e gëzon të drejtën e shfrytëzimit të pronës që është objekt kontesti. Pas ankesës së B.M. në Kolegjin e Apelit të KÇPB-së, ky i fundit më 16 dhjetor 2005, refuzoi ankesën e B.M. dhe vërtetoi vendimin e shkallës së parë KÇPB-së. Këto dy vendime të KÇPB -së, Gjykata nuk i posedon në shkresat e lëndës dhe po ashtu nuk gjendet as në dosjen e plotë të rastit që i është dorëzuar Gjykatës nga Gjykata Themelore në Prizren. Megjithatë, përmbajtja e këtij Vendimi konfirmohet si fakt në vendimet e tjera të gjykatave të rregullta, të pasqyruara në pjesën e përmbledhjes së fakteve të rastit.

109. Në ndërlidhje me këtë që u tha më lart Gjykata konstaton se Vendimi i KÇPB i 30 prillit 2005, ishte bërë përfundimtar sa i përket të drejtës së shfrytëzimit të pronës që është objekt kontesti.

110. Gjykata rikujton se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren, P. br.462/10, i 21 dhjetorit 2011, përmes së cilit e urdhëroi të paditurin B.M. që ta lirojë pronën e uzurpuar dhe të njëjtën ta kthejë në gjendje të mëparshme, duke i larguar të gjitha punimet të cilat i ka kryer në pronën në fjalë ishte bërë përfundimtar më 19 maj 2012, pasi që Gjykata e Qarkut në Prizren përmes Aktgjykimit Ac.nr.114/12 kishte refuzuar ankesën e B.M. dhe kishte vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale. Kundër këtyre dy Aktgjykimeve, B.M. kishte paraqitur revizion, të cilin Gjykata Supreme e kishte refuzuar si të pabazuar.

111. Në dritën e asaj që u cek më lart, Gjykata vëren që në rrethanat e rastit konkret nuk ka asnjë dilemë që ekziston një vendim përfundimtar dhe i ekzekutueshëm, respektivisht Vendimi i KÇPB-së sa i përket të drejtës së shfrytëzimit të pronës që është objekt kontesti si dhe Aktgjykimi P. br.462/10 i Gjykatës Komunale, i 21 dhjetorit 2011, e i cili është bërë i plotfuqishëm më 19 maj 2012 përmes së cilit e urdhëroi të paditurin B.M. që ta lirojë pronën e uzurpuar dhe të njëjtën ta kthejë në gjendje të mëparshme, duke i larguar të gjitha punimet të cilat i ka kryer në pronën në fjalë. Një gjë e tillë konfirmohet nga vendimmarrja e gjykatave të rregullta të cilat tashmë kanë konfirmuar që rasti duhet të përmbarohet në favor të parashtrueses së kërkesës.

112. Gjykata, po ashtu vëren se parashtruesja e kërkesës kishte iniciuar procedurë përmbarimore lidhur me zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, P.br.462/10, të 21 dhjetorit 2011. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesja e kërkesës është përpjekur vazhdimisht që vendimi i formës së prerë në rastin e saj të përmbarohet.

113. Në kontekst të kësaj, Gjykata konsideron se përmbarimi i një vendimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Brumărescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i 28 tetorit 1999).

114. Gjykata tutje thekson se është e drejtë e palës së pakënaqur që të iniciojë procedurë gjyqësore në rast të dështimit të realizimit të një të drejte të fituar që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, si dhe nenin 6 të KEDNJ. Do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi ligjor i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar dhe i plotëfuqishëm të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat na sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, parim të cilin institucionet e Republikës së Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, KI 04/12, parashtrues *Esat Kelmendi*, Aktgjykim i 11 korrikut 2012; rastin KI193/18, parashtrues *Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020, paragrafi 126) .

115. Në lidhje me këtë, Gjykata duke iu referuar edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së thekson se formalizmi i tepruar mund të mohojë esencën e së drejtës së kërkuar, për të siguruar qasje të drejtë dhe praktike në gjykata siç parashihet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Kjo zakonisht ndodhë kur aplikohen rregulla strikte procedurale, të cilat nuk lejojnë që kërkesat e parashtruesve të shqyrtohen në bazë të nivelit të arsyeshëm (shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 5 prillit 2018, *Zubac kundër Kroacisë*, nr. 40160/12).

116. Në rastin e parashtrueses së kërkesës, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të përcaktojë se cila është mënyra më e përshtatshme që gjykatat në kuadër të kompetencave që kanë të gjejnë mekanizmin efikas të natyrës ekzekutive për zbatimin e vendimit të formës së prerë.

117. Prandaj barra e mospërmbarimit dhe mosgjetjes së mekanizmave përkatës për përmbarimin e vendimeve të formës së prerë respektivisht Vendimit të KÇPB-së të 30 prillit 2005 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, P.br.462/10, të 21 dhjetorit 2011, e i cili është bërë i formës së prerë me 18 maj 2012, bie mbi Gjykatën Themelore.

118. Si përfundim, Gjykata konstaton se mospërmbarimi i vendimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm, përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përkitazi me pretendimet për cenim të së drejtës për mjete juridike efektive dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave

119. Gjykata merr në konsideratë pretendimet e parashtrueses së kërkesës që kanë të bëjnë me të drejtën për mjete juridike efektive dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

120. Së këndejmi, Gjykata i referohet nenit 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe nenit 13 të KEDNJ-së.

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj."

Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur."

Neni 13 i KEDNJ-së [E drejta për zgjidhje efektive]

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare."

121. Gjykata së pari rikujton pretendimin e parashtrueses së kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës, e cila thekson se "*Përkundër asaj që ankuesja ka mundur t'i shfrytëzojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, ato kanë mbetur joefikase [...] Kështu që e drejta për mjet efikas juridik në rastin konkret ka mbetur vetëm e drejtë formale në këtë kuptim, ndërsa ekzekutimi i vendimit të plotfuqishëm dhe përmbarimor gjyqësor është praktikisht i pazbatueshëm, sepse ankuesja nuk ka mjete financiare as ta ushqejë veten dhe familjen e*

vet, ndërsa mbi pagesën e paradhënies në shumën siç është precizuar më lartë as që bëhet fjalë".

122. Gjykata nënvizon se secili person ka të drejtë të shterojë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat i cenojnë të drejtat ose interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj (shih, *mutatis mutandis*, *Voytenko kundër Ukrainës*, nr. 18966/02, Aktgjykimi i 29 qershorit 2004, paragrafët 46-48).

123. Duke pasur parasysh konstatimet e saj lidhur me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, Gjykata konsideron se ankesat përkitazi me ato nene janë të "argumentueshme" për qëllime të neneve 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 27 prill 1998, paragrafi 52).

124. Gjykata rithekson se nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, përcaktojnë se sistemi juridik duhet të vë në dispozicion një mjet efektiv juridik që autorizon organin kompetent të adresojë thelbin e një pretendimi për shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih GJEDNJ, *Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2018, paragrafi 81 dhe referencat e përmendura aty).

125. GJEDNJ në disa raste ka potencuar se efekti i nenit 13 është detyrimi për shtetet që të ofrojnë mjete juridike efektive, që mundësojnë shqyrtimin e thelbit të një kërkese të argumentueshme sipas Konventës dhe për të mundësuar korrigjimin e duhur (shih vendimet e GJEDJ, *Kudla kundër Polonisë*, Aktgjykimi i 26 tetorit 2000; *Kaya kundër Turqisë*, Aktgjykimi i 19 shkurt 1999). Më tutje, GJEDNJ ka vënë në pah se neni 13 duhet të jetë "efektiv" në ligj dhe në praktikë (shih, për shembull, *Ilhan kundër Turqisë*, Aktgjykimi i 27 qershorit 2000). GJEDNJ, poashtu, ka theksuar se "efektiviteti i mjetit juridik", në kuptim të nenit 13 të KEDNJ, nuk është i kushtëzuar me garancinë për një zgjidhje të favorshme për parashtruesin e kërkesës (*Kudla kundër Polonisë*).

126. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, parashtruesja e kërkesës duke kërkuar përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, P.br.462/10, të 21 dhjetorit 2011, ajo u është drejtuar disa herë gjykatave të rregullta si dhe Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër,

Gjykata rithekson se në procedurën përmbarimore, gjykatat e rregullta kanë nxjerrë disa vendime në favor të parashtrueses – që lejuan përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, P.br.462/10, të 21 dhjetorit 2011, duke e obliguar F.M. që t'i paguajë shpenzimet që rrjedhin si rezultat i kryerjes së punëve (kthimin në gjendjen e mëparshme të pronës) – dhe disa vendime të kundërta dhe së fundmi vendimi i kontestuar i cili e pezullon procedurën përmbarimore, për shkak se parashtruesja e kërkesës ishte ngarkuar me shpenzimet e procedurës përmbarimore obligim ky të cilin nuk kishte mundur ta përmbushë në funksion të realizimit të së drejtës së saj.

127. Pra, parashtruesja e kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, P.br.462/10, të 21 dhjetorit 2011. Megjithatë, pavarësisht përpjekjes së saj, Aktgjykimi i lartcekur nuk është përmbaruar nga organet kompetente. Faktikisht, mjetet juridike të përdorura nga parashtruesja kërkesës, sikundër edhe vendimet gjyqësore në favor të saj, nuk kanë pasur ndonjë efekt praktik në situatën e saj.

128. Në mbështetje të kësaj, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, por të cilat rezultuan si joefektive në funksion të realizimit të së drejtës së saj.

129. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së, e cila në rastin *Klass kundër Gjermanisë* ka theksuar se "*kur një person konsideron se është paragjykuar përmes një akti për të cilin pretendon se është në kundërshtim me Konventën, ai duhet të këtë në dispozicion një mjet juridik para autoriteteve shtetërore, që do t'i mundësojë zgjidhjen e kërkesës së tij dhe, nëse duhet, ofrimin e kompensimit. Kështu, neni 13 duhet të interpretohet në atë mënyrë që të garantojë një mjet juridik efektiv para autoritetit shtetëror për secilin që pretendon se të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Konventë janë shkelur*" (shih GJEDNJ, *Klass kundër Gjermanisë*, Aktgjykimi i 6 shtatorit 1978, paragrafi 64).

130. Mosekzistimi i mjeteve juridike apo mekanizmave të tjerë efektive, për përmbarimin e aktgjykimit të plotfuqishëm në rastin para nesh, cenon të drejtën për mjete juridike efektive, të garantuar me nenin 32 dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, në ndërlidhje me të drejtën për zgjidhje efektive, të garantuar me nenin 13 të KEDNJ-së.

131. Ky qëndrim është në përputhje me praktikën e Gjykatës, e cila në rastin KI94/13 ka theksuar se "*mosekzistimi i mjeteve juridike apo mekanizmave të tjerë efektive, për përmbarimin e Aktvendimit të Drejtorisë (Komunale), ndikon në të drejtën për mjete juridike efektive, të garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së. Në bazë të këtyre dispozitave, secili person ka të drejtë të shterojë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat i cenojnë të drejtat ose interesat e tij në mënyrë në përcaktuar me ligj*" (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese: KI94/13, parashtrues *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 16 prillit 2014, paragrafi 90; shih *mutatis mutandis*, *Voytenko kundër Ukrainës*, Nr. 18966/02, Aktgjykimi i 29 qershorit 2004, paragrafët 46-48).

132. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të përcaktojë se cila do të ishte mënyra më e përshtatshme që gjykatat e rregullta, në kuadër të kompetencave që kanë, t'i gjejnë mekanizmat efikas për të përmbushur në mënyrë të plotë detyrimet që përcaktohen me ligj dhe Kushtetutë.

133. Barra e përmbarimit të vendimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm bie mbi gjykatat e rregullta, respektivisht mbi Gjykatën Themelore. Mungesa e mekanizmave zbatues të këtij autoriteti publik, në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë arsye për mohimin e të drejtës së parashtrueses së kërkesës që vendimi i formës së prerë dhe i detyrueshëm të ekzekutohet në dobi të saj.

134. Së këndejmi, Gjykata konsideron se është e patolerueshme që parashtruesja e kërkesës – pavarësisht nga përpjekjet e saj për më shumë se njëzet vjet – nuk i ka gëzuar të drejtat që i janë njohur asaj me Vendimin e KÇPB-së të 30 prillit 2005 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, P.br.462/10, të 21 dhjetorit 2011.

135. Gjykata po ashtu e konsideron të nevojshme të potencojë se parashtrueses së kërkesës nuk mund t'i ngarkohet faji për zvarritjen e procedurave dhe mospërmbarim të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, P.br.462/10, të 21 dhjetorit 2011, sepse ajo vetëm kishte shfrytëzuar mjetet juridike dhe kishte ndjekur rrugët gjyqësore, në pajtim me ligjin në fuqi (shih, *mutatis mutandis*, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, paragrafi 68).

136. Prandaj, Gjykata arrin në përfundim se pamundësia për të ndërmarrë veprime të mëtejshme ligjore për përmbarimin e Vendimit të KÇPB-së të 30 prillit 2005 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, P.br.462/10 të 21 dhjetorit 2011, paraqet gjithashtu shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të KEDNJ-së.

Përkitazi me pretendimet për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës

137. Gjykata së pari kujton përmbajtjen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

> "1. *E drejta e pronës është e garantuar.*
>
> *2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
>
> *3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.*
>
> *[...]"*
>
> *Neni 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së:*
>
> *1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*
>
> *2. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.*

138. Përmbajtja e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe zbatimi i tij, janë interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikës gjyqësore të saj, të cilës ashtu siç është theksuar më lart Gjykata do t'i referohet në lidhje me interpretimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

139. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata së pari vlerëson se e drejta në pronë sipas paragrafit 1 të nenit 46 të Kushtetutës garanton të drejtën e posedimit të pronës; paragrafi 2 i nenit 46 të Kushtetutës përcakton mënyrën e shfrytëzimit të pronës duke specifikuar qartë se shfrytëzimi i saj rregullohet me ligj dhe në pajtim me interesin publik; dhe, në paragrafin 3, garanton që askush nuk mund të privohet nga prona në mënyrë arbitrare, duke përcaktuar gjithashtu kushtet nën të cilat prona mund të shpronësohet (shih, *mutatis mutandis*, rasti i Gjykatës KI50/16, parashtrues i kërkesës *Veli Berisha dhe të tjerët*, Aktvendimi për papranueshmëri i 10 marsit 2017).

140. Ndërsa, sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, Gjykata vëren se GJEDNJ ka konstatuar se e drejta pronësore përbëhet nga tri rregulla të ndryshme. Rregulli i parë, i cili ka natyrë të përgjithshme, formulon parimin e gëzimit paqësor të pronës; kjo përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë. Rregulli i dytë përfshin privimin nga prona dhe ia nënshtron atë kushteve të caktuara; kjo përcaktohet në fjalinë e dytë të të njëjtin paragraf. Rregulli i tretë i njeh shteteve, ndërmjet të tjerash, të drejtën për të kontrolluar shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, me zbatimin e atyre ligjeve që ato i konsiderojnë të nevojshme për këtë qëllim; kjo përcaktohet në fjalinë e dytë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 shtatorit 1982, *Sporrong dhe Lonnrot kundër Suedisë*, nr. 7151/75; 7152/75, para. 61).

141. Të tri rregullat e lartcekura nuk janë, megjithatë, "të ndryshme" në kuptim të të qenit të pa ndërlidhura. Rregulli dy dhe tre kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës dhe prandaj duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të parashtruar në rregullin e parë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 shkurtit 1986, *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.* 8793/79, paragrafi 37).

142. Në rastin konkret, pretendimi i parashtrueses së kërkesës bie brenda rregullit të parë të përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, përkatësisht gëzimin paqësor të pasurisë. Kjo garanci gjithashtu përfshin, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen e pronës, të cilave parashtruesja e kërkesës i referohet dhe pretendon se përbëjnë shkelje të të drejtave pronësore në rastin e saj.

143. Gjykata rikujton që GJEDNJ në këtë drejtim konsideron se *"Ushtrimi i vërtetë dhe efektiv i të drejtave të mbrojtura nga kjo dispozitë nuk varet thjesht nga detyrimi i shtetit për të mos ndërhyrë, por mund të marrë masa mbrojtëse pozitive, veçanërisht kur ka një lidhje të drejtpërdrejt midis masave të cilat një parashtrues mund të presë në mënyrë legjitime nga autoritetet dhe gëzimin efektiv të pronës së tij"* (shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 30 nëntorit 2004, *Oneryildiz kundër Turqisë*, nr. 48039/99, para. 134).

144. Megjithatë, në përcaktimin nëse koncepti i detyrimeve pozitive, parandaluese ose përmirësuese, për të mbrojtur gëzimin paqësor të pasurisë zbatohet në rrethanat e parashtrueses së kërkesës, së pari, çështja që duhet shqyrtuar në rastin në fjalë është nëse rrethanat e rastit, të shqyrtuara në tërësi, i dhanë parashtrueses së kërkesës një titull të një interesi thelbësor të mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 qershorit 2004, *Broniowski kundër Polonisë*, nr. 31443/96, paragrafi 129).

Zbatimi i kritereve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

145. Gjykata fillimisht rikujton pretendimin e parashtrueses së kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, ku parashtruesja e kërkesës pretendon se pronën ka qenë e detyruar ta braktisë jo me dëshirën e saj, dhe prej më shumë se 19 vjet ajo edhe përkundër që kishte një vendim të plotfuqishëm me të cilin vërtetohej e drejta e shfrytëzimit të pronës kontestuese, parashtruesja është penguar ta shfrytëzojë atë.

146. Parashtruesja pretendon se prej vendimeve të KÇPB-së me të cilat është vërtetuar se parashtruesja gëzon të drejtën e shfrytëzimit të pronës kontestuese, e pastaj vendimeve të gjykatave të rregullta të cilat kanë qenë në favor të saj, ajo nuk ka mundur ta gëzojë pronën e saj në mënyrë paqësore.

147. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës kishte dy vendime të formës së prerë, përmes të cilave ishte vërtetuar se parashtruesja e kërkesës kishte të drejtën e shfrytëzimit të pronës kontestuese dhe B.M. ishte obliguar që pronën kontestuese ta kthejë në gjendje të mëparshme. Këto vendime nuk janë ekzekutuar, andaj, parashtruesja e kërkesës kishte iniciuar procedurën përmbarimore.

148. Prandaj, Gjykata konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk ka asnjë dilemë që ekzistojnë dy vendime të formës së prerë dhe të ekzekutueshme, respektivisht Vendimi i KÇPB-së i 30 prillit 2005 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, P.br.462/10, i 21 dhjetorit 2011.

149. Gjykata vëren gjithashtu se parashtruesja e kërkesës në pamundësi të realizimit të të drejtave të njohura me këto vendime, kishte iniciuar procedurë përmbarimore. Në procedurën përmbarimore ekzistojnë shumë vendime kundërthënëse të së njëjtës gjykatë.

150. Gjykata, nga shkresat e lëndës, vëren se fillimisht në procedurën përmbarimore Gjykata Komunale në bazë të propozimit për përmbarim të parashtrueses së kërkesës kishte aprovuar kërkesën e saj për përmbarim të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, P.br.462/10, të 21 dhjetorit 2011 dhe, edhe pas ankesës së B.M., në Gjykatën e Apelit i njëjti ishte konfirmuar.

151. Si rezultat i mosgjetjes së mekanizmave për ekzekutim të vendimit të formës së prerë, është ngritur çështja se kush është i obliguar të deponojë mjetet financiare, për kryerjen e punimeve në procedurë përmbarimore, Gjykata Themelore kishte kërkuar mendim juridik nga Gjykata Supreme e Kosovës.

152. Pas mendimit juridik të Gjykatës Supreme, Gjykata Themelore përmes Vendimit [I.br.1241/12] të 27 shkurtit 2017, duke u thirrur në nenin 13 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, kishte urdhëruar parashtruesen e kërkesës që të deponojë shumën e mjeteve, në emër të kryerjes së punimeve nga pala e tretë, të cilat janë paraqitur në procedurë përmbarimore. Lidhur me atë se kush duhet t'i paguajë shpenzimet lidhur me ekzekutimin e vendimit të lartpërmendur, Gjykata Themelore në Vendimin e saj kishte theksuar se në bazë të nenit 13 të LPP, paraprakisht shpenzimet lidhur me kryerjen e përmbarimit i paguan kreditori, në këtë rast parashtruesja e kërkesës, duke theksuar: *Nëse pala kreditore nuk i paguan shpenzimet e ekzekutimit në shumën e caktuar brenda periudhës së paraparë si në dispozitivin I të këtij vendimi, gjykata si organ përmbarues do ta ndaloj ekzekutimin në këtë çështje juridike ekzekutive I.br.1241/12,*

dhe nuk do të zbatoj veprimin përmbarues të përshkruar si në dispozitivin I/ të këtij vendimi".

153. Pas ankesës së parashtrueses së kërkesës në Gjykatën e Apelit, e njëjta e kishte refuzuar ankesën e saj, duke e vërtetuar Vendimin [I.br.1241/2012] të Gjykatës Themelore në Prizren, Vendim ky të cilin parashtruesja e kërkesës në mënyrë shprehimore e konteston para Gjykatës.

154. Në ndërlidhje me këtë, pavarësisht sa e ndërlikuar ka qenë situata juridike lidhur me ekzekutimin e vendimit gjyqësor në këtë rast dhe veçanërisht pasi që Gjykata Supreme në mendimin e saj juridik të 1 shkurtit 2016 kishte theksuar se sipas nenit 13 të LPP është e qartë që shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbarimit paraprakisht i paguan kreditori, në rastin konkret do të duhej të merreshin parasysh të gjitha rrethanat e rastit dhe jo vetëm mendimi juridik i Gjykatës Supreme

155. Prandaj si çështje e cila duhet të vlerësohet në këtë rast është nëse autoritetet publike të shtetit të Republikës së Kosovës, përfshirë gjykatat e rregullta, kanë vendosur një barrë proporcionale mbi parashtruesen e kërkesës e cila kërkon ekzekutimin e një vendimi të ligjshëm, përfundimtar dhe të plotfuqishëm që nga viti 2012. Për më tepër, siç edhe qartazi del nga parimet e mishëruara në nenin 31 dhe nenin 6 të KEDNJ, ekzekutimi i një vendimi është pjesë përbërëse e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Por përveç kësaj, kjo e drejtë ndërlidhet ngushtë edhe me nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së përmes së cilëve garantohet qasja në mjete efektive juridike për realizimin e të drejtave konkrete.

156. Gjykata vëren që parashtruesja e kërkesës ka bërë gjithë çfarë ka qenë e mundur nga ana e saj për të kërkuar realizimin e një të drejte që do duhej të ishte realizuar deri më tash. Ajo ka shfrytëzuar çdo mjet juridik dhe secili prej tyre, në një mënyrë ose tjetër, ka dështuar që asaj t'ia zgjidhë çështjen e ekzekutimit të një vendimi përfundimtar.

157. Nën dritën e parimeve të shtjelluara në lartë, në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, duke e pezulluar procedurën përmbarimore në lidhje më përmbushjen e detyrimit financiar dhe, vënia e barrës së këtij detyrimi mbi parashtruesen e kërkesës, si kusht për kryerjen e punëve përmbarimore në zbatim të një vendimi gjyqësor përfundimtar dhe të plotfuqishëm, e ka penguar zbatimin e një vendimi të tillë.

158. Gjykata nuk vëren që autoritetet të jenë munduar që të gjejnë një zgjidhje për parashtruesen e kërkesës, për shembull duke ia mundësuar asaj që të ketë qasje në pronën e saj – qoftë edhe përgjatë kohës kur prona e saj akoma nuk është kthyer në gjendjen e mëparshme.

159. Gjykata thekson se vonesat në implementimin e vendimeve përfundimtare me të cilat parashtrueses së kërkesës i është njohur e drejta e shfrytëzimit të pronës mund të cenojnë vet esencën e të drejtës respektive.

160. Gjykata vë në pah faktin se pavarësisht nëse debitori është një person privat ose institucion shtetëror i takon shtetit të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që vendimi përfundimtar gjyqësor të ekzekutohet dhe me atë rast të inkuadrojë sipas nevojës në mënyrë efikase të gjithë aparatin shtetëror (shih *ndërmarrja EVT kundër Serbisë,* Aktgjykim i GJEDNJ i 21 qershorit 2007 par. 48).

161. Andaj, detyrimi që i është ngarkuar parashtrueses së kërkesës me vendimet e fundit të gjykatave të rregullta kur kanë kërkuar nga parashtruesja e kërkesës që ajo të mbulojë shpenzimet e ekzekutimit të vendimit për të realizuar të drejtën e saj të gëzimit paqësor të pronës e veçanërisht në dritën e rrethanave të plota të rastit dhe faktit se ajo ishte liruar nga pagesa e taksës gjyqësore në mungesë të mjeteve materiale.

162. Parashtruesja e kërkesë më tutje pretendon se me vendimet e fundit me të cilat është pezulluar procedura përmbarimore, përfundimisht i kanë mohuar asaj të drejtën në pronë.

163. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata vlerëson se moskthimi në gjendjen e mëparshme në pronën kontestuese nuk është bazë për mohimin e të drejtës në pronë.

164. Gjykata, duke u bazuar në parimet të cilat janë shtjelluar më lartë, konstaton se Gjykata Themelore në Prizren, përmes Vendimit [I.br.1241/12], të 27 shkurtit 2017, duke u mbështetur në vazhdimësi nga Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [CA.nr.2093/2017] kishte përmbysur një vendim të Gjykatës Themelore i cili ishte bërë *res judicata,* në mungesë të gjetjes së mekanizmave për zbatimin e tij.

165. Sa i përket shkeljes së pretenduar për mbrojtjen e pronës në rastin konkret, Gjykata konstaton se Vendimi i KÇPB-së i 30 prillit 2005 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, P.br.462/10, i 21 dhjetorit 2011, përbënte pritje legjitime për parashtruesen e kërkesës, me të cilin është

urdhëruar B.M. ta lironte pronën që është objekt kontesti dhe të njëjtën ta kthente në gjendjen e mëparshme.

166. Në dritën e krejt kësaj, Gjykata vlerëson se barra me të cilën është ngarkuar parashtruesja e kërkesës për realizimin e të drejtës së saj nuk është proporcionale dhe, për më tepër pengon vet realizimin e të drejtës.

167. Gjykata konstaton se si pasojë e mospërmbarimit të këtij vendimi, parashtrueses së kërkesës i është mohuar e drejta për gëzimin paqësor të pronës së saj, në shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

168. Prandaj, parashtruesja e kërkesës ka të drejtë ta gëzojë në mënyrë paqësore pronën, ashtu siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Në këto rrethana asaj i është mohuar e drejta e gëzimit dhe posedimit të pronës (shih, *mutatis mutandis*, *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, nr 39794/98, par 73, GJEDNJ).

Kërkesa e parashtrueses së kërkesës për moszbulim të identitetit

169. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj kishte kërkuar gjithashtu që identiteti i saj të mos zbulohet, duke mos e specifikuar arsyen.

170. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 32 (6) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> "(6) *Palët në kërkesë që nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet në publik, duhet të tregojnë arsyet që justifikojnë një largim të tillë nga rregulli i qasjes publike në informata në procedurën në Gjykatë. Gjykata me shumicë votash autorizon moszbulimin e identitetit ose e jep atë pa një kërkesë nga një palë. Kur lejohet moszbulimi i identitetit nga Gjykata, pala duhet të identifikohet vetëm me iniciale ose me shkurtesa apo me një shkronjë të vetme.*"

171. Duke u bazuar në kërkesën e paraqitur nga parashtruesja e kërkesës, Gjykata konsideron se kjo nuk është bazë për miratimin e kësaj kërkese

(shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI74/17, parashtrues *Lorenc Kolgjeraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 dhjetorit 2017).

172. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtrueses së kërkesës për moszbulim të identitetit duhet të refuzohet.

Përfundim

173. Si përfundim, Gjykata konstaton se mospërmbarimi i Vendimit të KÇPB-së të 30 prillit 2005 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, P.br.462/10, të 21 dhjetorit 2011, në rastin e parashtrueses së kërkesës, përbën shkelje të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6.1 dhe 13 të KEDNJ-së.

174. Përveç kësaj, Gjykata konstaton se si rezultat i mospërmbarimit të vendimit të formës së prerë dhe të detyrueshëm, parashtruesja e kërkesës është privuar pa të drejtë nga prona e saj. Në këtë mënyrë është shkelur edhe e drejta e parashtrueses së kërkesës për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën e saj, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës, dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

175. Në fund, Gjykata konsideron se nuk duhet të merret më tej me pretendimet për shkelje të nenit 24 në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së, sepse pretendimet dhe kërkesat e tilla janë konsumuar nga konstatimet e Gjykatës për shkelje të neneve 31, 32, 54 dhe 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenin 13 si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenet 113.7 dhe 116.1 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 3 shkurt 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 dhe 13 të KEDNJ-së;

III. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së;

IV. TË KONSTATOJË se Vendimi i KÇPB-së, i 30 prill 2005 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren, P.br.462/10, i 21 dhjetorit 2011, janë vendime të formës së prerë dhe si të tilla duhet të përmbarohen nga autoritetet publike përgjegjëse;

V. TË SHFUQIZOJË Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, [CA.br.2093/2017], të 29 janarit 2018, dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren [I.br.1241/12], të 27 shkurtit 2017;

VI. TË URDHËROJË Gjykatën Themelore në Prizren, që në pajtim me rregullin 66 të Rregullores së punës së Gjykatës, ta njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 3 (tre) muaj, respektivisht deri më 3 maj 2021, Gjykatën Kushtetuese në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate;

VII. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VIII. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi

KI104/20, Parashtrues, Ejup Koci, Vlerësim i kushtetutshmërisë së procedurave në Gjykatën Themelore në Mitorivcë – Dega në Skenderaj, përkitazi me lëndën C.nr. 256/2018.

KI104/20, Aktgjykim i 22 marsit 2021

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, shkelje e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ky rast ka të bëjë me padinë e parashtruesit për vërtetim të kufirit (mezhdës) të palujtshmerisë dhe vërtetim të pronësisë si pjesë e uzurpuar. Parashtrusi i kerkeses pretendonte se Gjykata Themelore nuk ishte duke marr ndonje veprim kokrete per te zgjidhur rastin.
Gjykata konsideroj se Gjykata Themelore kishte komunikuar në mënyrë konstante me parashtruesin e kërkesës: (i) duke e njoftuar me statusin aktual te rastit te tij, (ii) duke kërkuara nga parashtruesi i kërkesës që të precizoj padinë dhe të paguaj taksën gjyqësore; (iii) duke vendosur që pala kundërshtare të ftohet në seancë dhe në fund (iv) duke liruar parashtruesin e kërkesës nga taksa gjyqësore.
Gjykata vëren se shqyrtimi i rastit të parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore ishte shoqëruar ne vazhdimsi me veprime njoftues dhe procedurale nga ana e Gjykatës Themelore. Në bazë të fakteve të rastit, Gjykata vëren se veprimi i fundit procedural i Gjykatës Themelore në rastin konkret ishte Aktvendimi [C.nr.256/2018] i 28 shtatorit 2020, përmes të cilit parashtruesi i kërkesës u lirua nga taksa gjyqësore.
Në këto rrethana, Gjykata gjen se Gjykata Themelore nuk ka qenë pasive në lidhje me rastin parashtruesit të kërkesës.
Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar pretendimin se ecuria e procedurës për vendosjen rreth rastit të tij ka rezultuar në tjezgjatje dhe moszgjidhje të rastit brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar me nenin 31.2 të Kushtetuese dhe me nenin 6.1 të KEDNJ-së.
Prandaj, kërkesa u shpall qartazi e pabazuar ne baza kushtetuese dhe u deklarua e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI104/20

Parashtrues

Ejup Koci

Vlerësim i kushtetutshmërisë së procedurave në Gjykatën Themelore në Mitorivcë – Dega në Skenderaj, përkitazi me lëndën C.nr. 256/2018

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

Kërkesa është parashtruar nga Ejup Koci (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Skenderaj.

Vendimi i kontestuar

Parashtruesi i kërkesës nuk e konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike. Ai konteston kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës C. nr. 256/2018, që është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes se procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës C.nr. 256/2018.

Baza juridike

Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

Më 30 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

Më 27 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument shtesë.

Më 6 korrik 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu Krasniqi.

Më 21 korrik 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Themelore.

Më 1 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë disa dokumente shtesë.

Më 10 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Parashtruesi parashtron kërkesë për herë të katërt në Gjykatë.

Në lidhje me kërkesën e parë, me 8 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën KI109/17 në Gjykatë, nëpërmjet të cilës kontestoi tej-zgjatjen e procedurave, përkatësisht zvarritjen e procedurës për vendosje në lëndën civile [C. nr. 0355/2011], e cila kishte të bënte me shpronësimin e paluajtshmerive për shkak të ndërtimit të rrugës ndër-komunale Skenderaj - Vushtrri. Parashtruesi, në atë rast pretendonte se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe 46 [Mbrojta e Pronës] te Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces te rregullt gjyqësor], në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-se. Me 30 maj 2018, Gjykata nxori Aktvendim për

papranueshmëri nr. KI109/17, me të cilin konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmoi në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (gjegjësisht të drejtën në gjykim të drejtë, brenda një afati kohor të arsyeshëm).

Në lidhje me kërkesën e dytë, me 22 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën nr. Kl161/18 në Gjykatë, nëpërmjet të cilës kontestoi Aktvendimin [Rev. Nr. 105/2018] të Gjykatës Supreme me pretendimin se nuk i është respektuar e drejta për qasje në gjykatë, ngase Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nuk morën parasysh provat e parashtruara nga ai. Parashtruesi në atë rast, pretendonte se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet: 31 [E drejta për Gjykim te Drejtë dhe te Paanshme], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësore] dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1, të KEDNJ-se. Me 23 korrik 2019, Gjykata shpalli kërkesën të papranueshme pasi që kërkesa nuk ishte dorëzuar brenda afatit ligjor.

Në lidhje me kërkesën e tretë, më 17 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën nr. KI64/19, nëpërmjet të cilës kontestoi Aktvendimin [Cnr. 204/2015] të Gjykatës Themelore. Më 26 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për tërheqjen e kërkesës nr. KI64/19. Gjykata, në këtë rast, duke iu referuar edhe praktikës se saj gjyqësore, vlerësoi se nuk ka ndonjë arsye bindëse për vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Aktvendimit të kontestuar, përkundër kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës së tij. Më 25 shtator 2019, Gjykata miratoi kërkesën për tërheqjen e kërkesës nr. KI64/19.

Faktet e rastit në lidhje me kërkesën e tanishme KI104/20

Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se më 7 korrik 2015, parashtruesi i kërkesës ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore për vërtetim të kufirit (mezhdës) të palujtshmerisë dhe vërtetim të pronësisë si pjesë e uzurpuar.

Më 17 janar 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [Cnr. 204/2015] ia ktheu padinë parashtruesit të kërkesës për plotësim dhe saktësim.

Më 27 janar 2017, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj kërkesës së Gjykatës Themelore për plotësim të padisë.

Më 12 prill 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument shtesë në Gjykatën Themelore dhe kërkoi përshpejtim të procedurës së shqyrtimit të rastit të tij.
Më 27 prill 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [Cnr.204/2015] ndërpreu procedurën kontestimore të parashtruesit të kërkesës dhe e udhëzoi këtë të fundit që të filloj procedurën për shqyrtimin e trashigimisë sepse në pronën e kontestuar, përveç parashtruesit të kërkesës kishte edhe pronarë të tjerë. Ndër të tjera, Gjykata Themelore theksoi se pasi të dihen pronarët në pronën e kontestuar mund të fillohet me procedura gjyqësore sipas rregullave të procedurës kontestimore.

Më 17 maj 2018, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore që të rifillonte procedura e ndërprerë përmes Aktvendimit [Cnr. 204/2015] të 27 prillit 2017, me arsyetimin se Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [Tc.nr.33/18] të 27 prillit 2018 kishte shpallur trashigimtarët në pronën e kontestuar.

Më 17 maj 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore një dokument shtesë dhe kërkoi rifillimin e procedurës së ndërprerë, kërkesë të cilën e kishte ripërsëritur disa herë dhe atë me: 4 qershor 2018; 14 gusht 2018; dhe me 7 shkurt 2019,

Më 25 shkurt 2019, Gjykata Themelore njoftoi parashtruesin e kërkesës se rasti [C.nr.204/2015] është në procedurë dhe se më tutje identifikohet me shifrën e re [C.nr. 256/2018].

Më 4 prill 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoj nga Gjykatë Themelore që të shqyrtojnë rastin e tij [C.nr.256/2018].

Më 21 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoj nga Gjykatë Themelore që të shqyrtojnë rastin e tij [C.nr.256/2018].

Më 9 korrik 2019, Gjykata Themelore në afat prej 15 ditësh kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të sjell adresën e saktë për palën kundërshtare H.K., në mënyrë që të i dërgohet ftesa për seancën e radhës.

Më 15 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore që t'ia lëshoj certifikatën gjyqësore në mënyrë që të marr adresën e saktë të palës kundërshtare H.K.

Më 29 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore që ta informoi lidhur me statusin aktual të rastit të tij.

Më 11 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoi përsëri nga Gjykata Themelore që ta informoi lidhur me statusin aktual të rastit të tij.

Më 23 janar 2020, Gjykata Themelore e njoftoi parashtruesin e kërkesës së rasti i tij është duke u shqyrtuar me prioritet dhe se së shpejti do të caktohet edhe seanca.

Më 4 shkurt 2020, Gjykata Themelore nxori aktvendim përmes të cilit kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta precizojë/plotësojë padinë në kuptimin subjektiv dhe vendosi që pala kundërshtare H.K., të ftohet në seancën e radhës.
Më 6 mars 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Themelore për tejzgjatjen e shqyrtimit të rastit të tij dhe kërkoi përjashtimin e gjyqtarit mbikëqyrës në rastin e tij.

Më 22 qershor 2020, Gjykata Themelore ftoi parashtruesin e kërkesës që të paraqitet në Gjykatën Themelore dhe të paguaj taksën gjyqësore në vlerë prej 20 euro, në emër të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit. Gjithashtu, Gjykata Themelore njoftoi parashtruesin e kërkesës se në rast të mos pagesës së taksës gjyqësore do të konsiderohet se është hequr dorë nga kërkesa e paraqitur.

Më 28 shtator 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr. 256/2018] vendosi që parashtruesin e kërkesës ta liroj nga taksa gjyqësore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Për shkak se me mosveprimet-veprimet e GJTHM- dega në Skenderaj me është pamundesuar qasja në Gjykatë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventat Ndërkombëtare. Më është pamundesua barazia para ligji (neni 3.2 i KRK-ës). Më është pamundesuar mbrojtja e Pronës (neni 46), gjykimi në afat te arsyeshem, trajtim ndryshe nga të tjerët- diskriminim (neni 24), mos respektim i të drejtave njerëzore n(eni 21.3 i Kushtetutës)."*

Parashtruesi i kërkesës, kërkon nga Gjykata që të *"[...] kërkoi nga Gjykata Kushtetuese që të nxjerr aktgjykim me të cili do të konstatoi se ka shkelje të drejtave njerëzore si: - e drejta për qasje në gjykata, për mbrojtje ligjore të pronës, gjykim të drejtë e të pa anëshem, mbrojtjen gjyqësore të drejtave (neni 54) gjykim në afat të arsyeshem, ndalim i diskriminimit (trajtimi ndryshe nga të tjerët)"*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç parashikohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], që parasheh:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *2. Individi mund ta ngrit kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*
>
> *(...)".*

Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmerisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmerisë] të Rregullores se punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores se punës përcakton kriteret në bazë të se cilave Gjykata mund të shqyrtoje kërkesën, duke përfshire kriterin që kërkesa të mos jete qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

> *"(2) Gjykata mund ta konsideroje kërkesën te papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se lënda e tij po zvarritet nga Gjykata Themelore. Në thelb, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje

kushtetuese si rezultat i mosveprimit dhe kohëzgjatjes se procedurave lidhur me shqyrtimin e rastit të tij nga ana e Gjykatës Themelore.

Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së:

Neni 31.2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës

"[...]
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet [...] brenda një afati të arsyeshëm [...]".

Neni 6.1 (E drejta për gjykim të drejtë) i KEDNJ-së

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm ...".

Për të verifikuar bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljet e të drejtave dhe lirive kushtetuese që kanë të bëjnë me marrjen e vendimeve brenda një kohe të arsyeshme, Gjykata do të merret me: *i)* vërtetimin e periudhës së kohëzgjatjes të procedurës në tërësi në institucionet kompetente, *ii)* parimet relevante në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave, dhe *iii)* arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave para Gjykatës Themelore.

i) Periudha që do të merret parasysh

Në rastin konkret, Gjykata vëren se në korrik 2017, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padinë në Gjykatën Themelore për vërtetim të kufirit (mezhdës) të palujtshmerisë, dhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë në lidhje me ngastrat e kontestuara.

Në këtë drejtim, Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore që duhet të merret parasysh, do ta marrë fillimin e procedurës, pra muajin korrik 2017, që është data kur parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore si dhe 30 qershorin 2020, kur parashtruesi paraqiti kërkesë në Gjykatë.

Prandaj, Gjykata vëren se periudha që duhet marrë parasysh në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, sipas nenit 31.2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, është 4 (katër) vjet e 11 (njëmbëdhjetë) muaj e 26 (njëzetegjatë) ditë.

ii) Parimet relevante

Gjykata para së gjithash thekson se, sipas praktikës konsistente të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, dhe në veçanti: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e palëve në procedurë; (c) sjelljen e gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 7 shkurtit 2002, *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, paragrafi 38; Shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI23/16, parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 majit 2017, paragrafi 58).

iii) Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

Gjykata vëren se ky rast ka të bëjë me padinë e parashtruesit për vërtetim të kufirit (mezhdës) të palujtshmerisë dhe vërtetim të pronësisë si pjesë e uzurpuar.

Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së që kishte sqaruar se ndërlikueshmëria e rastit mund të ndërlidhet me çështje faktike dhe ligjore por gjithashtu mund të ndërlidhet edhe me përfshirjen e disa palëve në procedurë apo me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 19 shtatorit 1994, *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, Nr. 21/1993/416/495, paragrafi 55; Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 7 shkurtit 2002, *H. kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 9580/81, paragrafi 72; Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 15 tetorit 1999, *Humen kundër Polonisë* nr. 26614/95, paragrafi 63.)
Në këtë drejtim, për të konstatuar nëse kohëzgjatja e procedurës ka qenë e arsyeshme, Gjykata duhet të merr parasysh faktorët siç janë: ndërlikueshmeria e rastit, sjellja e parashtruesit të kërkesës si dhe sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore. (Shih rastin *Konig kundër Gjermanisë*, GJEDNJ, aplikacioni nr. 6232/73, Aktgjykimi i 28 qershorit 1978, paragrafi 99).

Ndërlikueshmeria e rastit mund të rrjedh, për shembull, nga numri i padive, numri i palëve të përfshira në procedurë, siç janë të pandehurit dhe dëshmitarët apo dhe përmasa ndërkombëtare e rastit (Shih rastin Neumeister kundër Austrisë, GJEDNJ, aplikacioni nr. 1936/63, Aktgjykimi i 27 qershorit 1968, paragrafi 20).

Në rastin konkret, Gjykata vëren se rasti i parashtruesit të kërkesës kishte të bënte edhe me palë të tjera. Për pasoj, rasti i tij iu nënshtrua dy palë

procedurave, procedurës për shqyrtimin e trashëgimisë mbi pronën e kontestuar sepse në pronën e kontestuar, përveç parashtruesit të kërkesës kishte edhe pronarë të tjerë dhe me pastaj procedurës gjyqësore për vërtetimin e pronësisë.

Gjykata vëren se me 17 maj 2018, parashtruesi i kërkesës kërkoj nga Gjykata Themelore të rifilloj procedurën e ndërprerë përmes Aktvendimit [Cnr. 204/2015] të 27 prillit 2017, me arsyetimin se Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [Tc.nr.33/18] të 27 prillit 2018 kishte shpallur tashmë trashigimtarët në pronën e kontestuar.

Gjykata vëren gjithashtu se Gjykata Themelore kishte komunikuar në mënyrë konstante me parashtruesin e kërkesës: (i) duke e njoftuar me statusin aktual te rastit te tij, (ii) duke kërkuara nga parashtruesi i kërkesës që të precizoj padinë dhe të paguaj taksën gjyqësore; (iii) duke vendosur që pala kundërshtare të ftohet në seancë dhe në fund (iv) duke liruar parashtruesin e kërkesës nga taksa gjyqësore.

Gjykata vëren se shqyrtimi i rastit të parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore ishte shoqëruar ne vazhdimsi me veprime njoftues dhe procedurale nga ana e Gjykatës Themelore. Në bazë të fakteve të rastit, Gjykata vëren se veprimi i fundit procedural i Gjykatës Themelore në rastin konkret ishte Aktvendimi [C.nr.256/2018] i 28 shtatorit 2020, përmes të cilit parashtruesi i kërkesës u lirua nga taksa gjyqësore.

Në këto rrethana, Gjykata gjen se Gjykata Themelore nuk ka qenë pasive në lidhje me rastin parashtruesit të kërkesës.

Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6. 1 i Konventës nuk i obligojnë parashtruesit e kërkesave që aktivisht te bashkëpunojnë me autoritetet gjyqësore. Ata, po ashtu, nuk mund të fajësohen për shkak te shfrytëzimit të plotë të mjeteve juridike të vëna në dispozicion nga ligji ne fuqi. Megjithatë, sjellja e tyre, përbën një fakt objektiv që nuk mund t'iu atribuohet autoriteteve publike dhe që duhet marrë parasysh në konstatimin nëse procedurat vazhduan me gjatë se sa afati i arsyeshëm i përcaktuar me nenin 6.1 te Konventës (Shih rastin Eckle kundër Gjermanisë, GJEDNJ, aplikacioni nr. 8130/78, Aktgjykimi i 15 korrikut 1982, paragrafi 82).

Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6. 1 i Konventës obligojnë autoritetet kompetente që ta organizojnë sistemin gjyqësor në atë mënyrë që gjykatat t'i përmbushin të gjitha kriteret e përcaktuara ne nenin në fjalë (Shih rastin Abdoella kundër Holandës, GJEDNJ, aplikacioni nr. 12728/87, Aktgjykimi i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24).

Edhe pse rastet mund te jenë komplekse, Gjykata, megjithatë, mund t'i konsiderojë si të "arsyeshme" periudhat e gjata të mungesës se aktivitetit gjyqësor. (Shih rastin Adiletta kundër Italisë, aplikacioni nr. 20/1990/211/271- 273, GJEDNJ, Aktgjykim i 24janarit 1991,paragrafi 17).

Në të vërtetë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore ishte aktive, nuk kishte qëndruar e heshtur dhe kishte ndërmarrë veprime njoftuese dhe procedurale për rastin e parashtruesit të kërkesës.

Gjykata dëshiron të sqaroj se nuk ka njohuri nëse Gjykata Themelore ka nxjerrur apo pritet që të nxjerrë ndonjë vendim në merita lidhur me parashtresat e parashtruesi të kërkesës.

Për me tepër, Gjykata vëren se procedura është akoma në zhvillim e sipër dhe se nuk ka vendim përfundimtar.

Gjykata thekson se gjykatat e rregullta kanë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor, që çështjet t'i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që të mos shkaktojnë huti dhe pasiguri. Gjykatat e rregullta nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore të tjetra. Përndryshe, besimi i publikut ndaj tërë rendit juridik do të minohej.

Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar pretendimin se ecuria e procedurës për vendosjen rreth rastit të tij ka rezultuar në tjezgjatje dhe moszgjidhje të rastit brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar me nenin 31.2 të Kushtetuese dhe me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar ne baza kushtetuese dhe duhet te deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KETO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 10 shkurt 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJE këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJE këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me
nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi

KI45/20 dhe KI46/20, Parashtrues: Tinka Kurti dhe Drita Millaku, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, AA.nr. 4/2020, i 19 shkurtit 2020 dhe AA.nr.3/2020, i 19 shkurtit 2020

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, diskriminimi gjinor, kuota gjinore, e drejta pasive e votës*

Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës [AA.nr. 4/2020], të datës 19 shkurt 2020 dhe [AA.nr.3/2020], të datës 19 shkurt 2020. Parashtrueset e kërkesës pretendonin se me vendimet e kontestuara u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tyre të garantuara me nenet: 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 45 [Të drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe me nenin 3 (E Drejta për Zgjedhje të Lira) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkesa bazohej në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.

Përfundime

Rastet e bashkuara KI45/20 dhe KI46/20 janë dy raste që kanë të bëjnë me kontestet rreth zgjedhjeve të 6 tetorit 2019. Kërkesat janë parashtruar nga dy kandidate (Tinka Kurti dhe Drita Millaku) për deputete nga subjekti politik i Lëvizjes VETËVENDOSJE! (LVV) – të cilat pretendonin se KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme kanë zbatuar në mënyrë kundërkushtetuese mënyrën e zëvendësimit të deputetëve të përcaktuar me nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Gjykata rikujton që disa deputetë të subjektit politik LVV, të cilët u zgjodhën në pozita qeveritare/komunale, liruan disa pozita të deputetëve të cilat duhej të zëvendësoheshin me kandidatët e ligjshëm në radhë për deputetë. Kësisoj, nga deputetët të cilët liruan ulëset e tyre u bënë zëvendësimet vijuese: kandidati Enver Haliti me 7,777 vota zëvendësoi deputetin Albin Kurti; kandidati Alban Hyseni me 7,767 vota zëvendësoi deputetin Glauk Konjufca; kandidatja Arta Bajralia me 7,674 vota zëvendësoi deputeten Albulena Haxhiu; kandidati Fitim Haziri me 7,542 vota zëvendësoi deputetin Arben Vitia; kandidati Eman Rrahmani me 7,044 vota zëvendësoi deputetin Haki

Abazi. Më vonë, kandidati Taulant Kryeziu me 6968 vota zëvendësoi deputetin Shpejtim Bulliqi.

Domosdoshmëria e zëvendësimit të deputetëve aktivizoi në mënyrë automatike dispozitat ligjore të përcaktuara me nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – nen ky që specifikon mënyrën e zëvendësimit të deputetëve, me tekst vijues:

> *"112.2 Një anëtar i Kuvendit të Kosovës mandati i të cilit përfundon në pajtim me nenin 112.1 zëvendësohet si vijon:*
> *a) nga kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini i cili ka fituar numrin më të madh të votave të listës së riorganizuar të kandidatëve të Subjektit Politik në emër të së cilës garoi anëtari; [...]"*

Gjykata vëren se, sipas interpretimit që këtij neni iu është bërë nga KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme, të gjitha zëvendësimet ishin bërë bazuar në kriterin e *"gjinisë"* dhe pa marrë parasysh rezultatin e arritur nga kandidatët për deputetë pas plotësimit të kuotës obligative ligjore për përfaqësim prej 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë. Kësaj mënyre të zëvendësimit të paraparë me ligj, sipas Gjykatës Supreme, nuk kanë mundur t'i shmangen as KQZ, as PZAP e as Gjykata Supreme ngase ekziston supozimi se ligjet janë në pajtim me Kushtetutën dhe se ato duhet zbatuar ashtu siç janë, *"deri sa nga Gjykata Kushtetuese të konstatohet se një ligj ose ndonjë dispozitë ligjore e tij është në kundërshtim me Kushtetutën"*.

Duke mos u pajtuar me këtë interpretim, parashtrueset e kërkesave dorëzuan kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese, nën pretendimin kyç se KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme e kanë zbatuar në mënyrë kundërkushtetuese mënyrën e zëvendësimit të deputetëve të paraparë me nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në thelb, ato pretenduan se përkundër plotësimit dhe tejkalimit të kuotës prej 30% nga kandidatet gra për deputete nga LVV – zëvendësimet për deputetë ishin bërë jo bazuar në rezultat zgjedhor por bazuar në gjini. Sipas tyre, kjo gjë ka shkaktuar pabarazi në trajtim dhe shkelje të së drejtës së tyre për t'u zgjedhur.
Gjykata rikujton që, bazuar në mënyrën e zëvendësimit të aplikuar nga KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme, deputetët burra ishin zëvendësuar nga kandidatët burra për deputetë dhe deputetet gra ishin zëvendësuar nga kandidatet gra për deputete – përkundër faktit që parashtrueset e kërkesave kishin marrë më shumë vota se disa nga kandidatët burra që arritën të zgjedhën deputetë të Kuvendit. Parashtruesja e parë, Tinka Kurti kishte mbledhur 7655 vota dhe parashtruesja e dytë, Drita Millaku kishte mbledhur 7063.

Gjykata sqaroi se, nuk është duke vlerësuar *in abstracto* nëse neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është apo nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën. Kjo për faktin që, as para kësaj Gjykate e as para institucioneve paraprake publike që e kanë trajtuar këtë çështje, parashtrueset asnjëherë nuk kanë pretenduar që neni në fjalë është kundërkushtetues. Përkundrazi, parashtrueset vetëm kanë pretenduar që ky nen është zbatuar në mënyrë kundërkushtetuese nga KQZ, PZAP e Gjykata Supreme.

Duke marrë për bazë faktet e mësipërme dhe pretendimet e ngritura në këtë rast, Gjykata në këtë **ankesë individuale kushtetuese** trajtoj faktin se: A është zbatuar neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nga ana e KQZ-së, PZAP-së dhe Gjykatës Supreme, në përputhje me garancitë, vlerat dhe parimet e proklamuara me nenet 24 dhe 45 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së?

Gjykata Kushtetuese konstatoi se, interpretimi i këtij neni nga ana e KQZ-së, PZAP-së dhe Gjykatës Supreme nuk është interpretim i saktë dhe kushtetues për disa nga arsyet vijuese – të cilat janë gjerësisht të shtjelluara në Aktgjykim.

Së pari, Gjykata konstatoi se KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme, e kanë interpretuar nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në mënyrë të ngurtë e tekstuale dhe të shkëputur nga të gjitha normat e tjera ligjore të parapara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Barazi Gjinore si dhe parimet, vlerat dhe frymën e shkronjës e Kushtetutës. Ky lloj interpretimi ka abstrahuar kontekstin, qëllimin dhe arsyen e vendosjes së kuotës prej 30%, si masë e veçantë për të ndihmuar drejt arritjes së përfaqësimit të barabartë në mes të dy gjinive në Kuvendin e Republikës.

Së dyti, Gjykata potencoi se *ratio legis* i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron – në çdo rrethanë -përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë (cilado qoftë ajo). Mirëpo, qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të njërës gjini. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se, në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nënpërfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e ardhshme duhet të bëhen në bazë të renditjes të kandidatëve për deputetë, të cilën e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%, ndonëse ideali kushtetues dhe fryma e Kushtetutës, e reflektuar në nenin 7, synojnë arritjen e barazisë faktike 50% me 50% në mes të dy gjinive.

Së treti, Gjykata theksoi se interpretimi i nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme sipas mënyrës së interpretimit nga KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme, do të kishte kuptim vetëm në situatën kur mund të ndodhë që mos-zëvendësimet gjini-për-gjini (grua-për-grua ose burrë-për-burrë) do të mund të rrezikonin mos-përmbushjen e kuotës ligjore prej 30% të përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar. Mirëpo, interpretimi i këtij neni, në mënyrën siç është bërë, kur dihet se në zgjedhjet e 6 tetorit 2019 kandidatet gra të subjektit politik LVV kishin arritur të merrnin vota meritore përtej përqindjes së kuotës ligjore prej 30%, është interpretim i gabuar i kësaj norme dhe në shpërputhje me vet qëllimin e kuotave ligjore të përcaktuara me nenin 27 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Së katërti, Gjykata potencoi se qëllimi i vendosjes së kuotave ndërlidhet me nevojën për avancimin e barazisë gjinore brenda një shoqërie deri në arritjen e një barazie faktike, kur kuotat bëhen të panevojshme. Neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ekziston për një arsye të vetme: të paraqes mënyrën e zëvendësimit të deputetëve – gjithnjë duke ruajtur qëllimin e përfaqësimit obligativ ligjor prej të paktën 30% të gjinisë pakicë. Nëse pas plotësimit të normës prej 30%, kandidatët nga gjinia pakicë (të nënpërfaqësuar) arrijnë të bëhen deputetë me forcat e tyre vetanake duke korrur rezultat më të mirë se sa pjesëtarët e gjinisë shumicë, atyre nuk duhet t'u mohohet e drejta për t'u zgjedhur deputetë të Kuvendit.

Gjykata konstatoi se, parashtruesja Tinka Kurti është diskriminuar në bazë të gjinisë në lidhje me të drejtën e saj për t'u zgjedhur, në momentin kur edhe përkundër përmbushjes së kuotës minimale 30% përmes rezultatit zgjedhor në kuadër të subjektit politik LVV, në momentin kur u krijua mundësia e zëvendësimit të deputetëve, e njëjta edhe pse kishte më shumë vota se kandidatët burra për deputetë Fitim Haziri dhe Eman Rrahmani, nuk iu mundësua që të bëhej deputete.

Më tutje, Gjykata gjithashtu konstatoi se, parashtruesja Drita Millaku është diskriminuar në bazë të gjinisë në lidhje me të drejtën e saj për t'u zgjedhur, në momentin kur edhe përkundër përmbushjes së kuotës minimale 30% nëpërmjet rezultatit zgjedhor në kuadër të subjektit politik LVV, në momentin kur u krijua mundësia për zëvendësimet e ardhshme të deputeteve, përkatësisht kur dha dorëheqje deputeti Shpejtim Bulliqi, në vend të tij, në bazë të përcaktimit për zëvendësim në kuadër të gjinisë së njëjtë, më 18 dhjetor 2020, mandat deputeti mori kandidati Taulant Kryeziu me 6968 vota.

Si rrjedhojë, Gjykata konstatoi që: Aktvendimi [AA. nr. 4/2020] i 19 shkurtit 2020, i Gjykatës Supreme; Aktvendimi [AA. nr. 3/2020] i 19 shkurtit 2020, i Gjykatës Supreme; Vendimi i PZAP [Anr. 35/2020] i 13 shkurtit 2020; Vendimi i PZAP [Anr. 36/2020] i 13 shkurtit 2020; si dhe pika 5 e Vendimit

të KQZ [nr. 102/A-2020] i 7 shkurtit 2020, janë në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 3 (E Drejta për Zgjedhje të Lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

Efekti i Aktgjykimit

Gjykata vërejti se, për arsye objektive dhe në interes të sigurisë juridike, ky Aktgjykim nuk mund të prodhojë efekt juridik prapaveprues në lidhje me mandatet e deputetëve. Në këtë aspekt, Gjykata sqaroi se ky Aktgjykim nuk ka efekt prapaveprues dhe që në bazë të parimit të sigurisë juridike nuk prek të drejtat e palëve të treta të fituara në bazë të vendimeve të anuluara me këtë Aktgjykim. Megjithatë, kjo nuk nënkupton që ky Aktgjykim është thjesht deklarativ dhe pa asnjë efekt.

Efekti i parë i këtij Aktgjykimi është shfuqizimi i vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme, PZAP-it dhe KQZ-së, si të papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, në aspekt të interpretimit të nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Përmes shfuqizimit të këtyre vendimeve, ky Aktgjykim sqaron për të ardhmen se, bazuar në një lexim të saktë dhe kontekstual të nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, zëvendësimi i kandidatëve për deputetë duhet të bëhet në atë mënyrë që: *së pari*, të sigurohet përfaqësimi minimal në masën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar (gjinisë pakicë), e cila nuk mund të vihet në pikëpyetje në asnjë moment; dhe *së dyti*, në rastet kur kuota gjinore prej 30% është përmbushur bazuar në rezultatin zgjedhor (siç ishte rasti konkret), atëherë zëvendësimet e kandidatëve për deputetë duhet të bëhen në bazë të rezultatit zgjedhor, pa u kufizuar në aspektin e zëvendësimit në bazë të gjinisë së njëjtë, përderisa nuk rrezikohet minimumi i përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar.

Efekti i dytë që ky Aktgjykim mundëson, ka të bëjë me të drejtën që iu lind parashtrueseve të kërkesave ose palëve të tjera që mund të preken nga ky Aktgjykim, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij të fundit. Këtyre palëve iu lind e drejta për shfrytëzimin e mjeteve të tjera juridike në dispozicion për realizimin e mëtejmë të të drejtave në përputhje me gjetjet e këtij Aktgjykimi dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së të cituar në këtë Aktgjykim.

AKTGJYKIM

në

rastet KI45/20 dhe KI46/20

Parashtrues

Tinka Kurti dhe Drita Millaku

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, AA.nr. 4/2020, i 19 shkurtit 2020 dhe AA.nr.3/2020, i 19 shkurtit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtrueset e kërkesës

1. Kërkesa KI45/20 është dorëzuar nga Tinka Kurti, në cilësi të kandidates së Lëvizjes VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejmë: LVV) për zgjedhjet e 6 tetorit 2019, me banim në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e parë e kërkesës).

2. Kërkesa KI46/20 është dorëzuar nga Drita Millaku, në cilësi të kandidates së LVV për zgjedhjet e 6 tetorit 2019, me banim në Komunën e Prizrenit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e dytë e kërkesës).

Vendimet e kontestuara

3. Parashtruesja e kërkesës KI45/20 – Tinka Kurti konteston Aktvendimin [AA .nr. 4/2020] e 19 shkurtit 2020, të Gjykatës

Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme).

4. Parashtruesja e kërkesës KI46/20 – Drita Millaku konteston Aktvendimin [AA. nr. 3/2020] e 19 shkurtit 2020, të Gjykatës Supreme.

Objekti i çështjes

5. Objekti i çështjes së dy kërkesave në fjalë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme, përmes së cilave parashtrueset e kërkesës pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 45 [Të drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 3 mars 2020, parashtrueset e kërkesës dorëzuan kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi – Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

9. Më 19 maj 2020, bazuar në rregullin 40 të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI45/20 dhe KI46/20.

10. Më 3 qershor 2020, Gjykata njoftoi parashtrueset e kërkesës për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave KI45/20 dhe KI46/20.

11. Më 3 qershor 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave KI45/20 dhe KI46/20 dhe i dërgoi një kopje të kërkesës.

12. Më 3 korrik 2020, Avokati i Popullit paraqiti para Gjykatës *"Mendim Juridik i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në cilësinë e mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, [A.nr.193/2020], Tinka Kurti në lidhje me kërkesën për Aktvendimin AA.nr.4/2020 të znj. Tinka Kurti kundër Gjykatës Supreme të Kosovës"*.

13. Më 14 janar 2021, në bazë të paragrafit (1) të rregullit 55 [*Amicus Curiae*] të Rregullores së punës, Gjyqtari raportues u konsultua me Kolegjin shqyrtues lidhur me miratimin e kërkesës së Avokatit të Popullit për tu paraqitur si *Amicus Curiae* lidhur me rastin KI45/20.

14. Më 15 janar 2021, pas konsultimit me Kolegjin shqyrtues, Gjyqtari raportues miratoi kërkesën e Avokatit të Popullit që të paraqitet si *Amicus Curiae*, duke pranuar kështu Mendimin Juridik të dorëzuar, si pjesë përbërëse e dosjes së rastit. Në të njëjtën ditë, Gjyqtari raportues njoftoi të gjithë gjyqtarët e Gjykatës mbi vendimin për lejimin e pjesëmarrjes së Avokatit të Popullit në cilësinë e *Amicus Curiae* në rastin KI45/20.

15. Më 18 shkurt 2021 si dhe me 24 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi rastin dhe vendosi që rasti të shtyhet për shqyrtim në një nga seancat e radhës, me kërkesë që i njëjti të plotësohet.

16. Më 26 mars 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

17. Po të njëjtën datë, Gjykata votoi, njëzëri, se ka pasur shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenit 14 (Ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Për rrjedhojë, Gjykata i shpalli si të pavlefshme: (i) Aktvendimet [AA. nr. 3/2020 dhe AA. nr. 4/2020] e

Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 19 shkurtit 2020; (ii) Vendimet [Anr. 35/2020 dhe Anr. 36/2020] të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, të 13 shkurtit 2020; dhe pikën 5 të Vendimit [nr. 102/A-2020] të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të 7 shkurtit 2020.

18. Më 29 mars 2021, Gjykata publikoi Aktgjykimin në këtë rast.

Përmbledhja e fakteve

19. Më 6 tetor 2019, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi).

20. Më 27 nëntor 2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: KQZ) certifikoi rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend.

21. Më 5 shkurt 2020, Presidenti i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Presidenti), përmes kërkesës [Nr.102/2020], kërkoi nga KQZ-ja rekomandimin e kandidatëve të ligjshëm të radhës, që pasojnë sipas subjekteve politike përkatëse për zëvendësimin e deputetëve të Kuvendit, bazuar në rezultatet e certifikuara të zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, pasiqë një numër i deputetëve ishin zgjedhur në poste qeveritare, rrjedhimisht të njëjtit duhej të zëvendësoheshin.

22. Më 7 shkurt 2020, KQZ, përmes Vendimit [Nr.Prot. 102/A-2020], i dërgoi Presidentit *"Rekomandimin për kandidatët e radhës për deputetë të Kuvendit të Kosovës",* me ç' rast rekomandoi kandidatët e radhës për deputetë të Kuvendit në listën e subjektit LVV, si në vijim: kandidati Enver Haliti të zëvendësoje deputetin Albin Kurti – për shkak se është zgjedhur Kryeministër i Republikës së Kosovës; kandidati Alban Hyseni të zëvendësoje deputetin Glauk Konjufca, për shkak se është zgjedhur Ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës; kandidatja Arta Bajralia të zëvendësojë deputeten Albulena Haxhiu, për shkak se është zgjedhur Ministre e Drejtësisë; kandidati Fitim Haziri të zëvendësoje deputetin Arben Vitia, sepse është zgjedhur Ministër i Shëndetësisë dhe; kandidati Eman Rrahmani të zëvendësojë deputetin Haki Abazi, sepse është zgjedhur Zëvendëskryeministër i dytë [...].

23. Sipas KQZ-së, ky zëvendësim është bërë duke u bazuar në pikën a të paragrafit 2 të nenit 112 [Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendit], të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme ose LZP), që përcakton se zëvendësimi i deputetit bëhet *"nga kandidati i*

ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini i cili ka fituar numrin më të madh të votave të listës së riorganizuar të kandidatëve të Subjektit Politik në emër të së cilës garoi anëtari". Duke vepruar në këtë mënyrë, kandidatët e zëvendësuar nga lista e certifikuar nga KQZ, me 27 nëntor 2019, për zgjedhjet e 6 tetorit 2019, që u bënë deputetë ishin: Enver Haliti me numër rendor 71, me 7.777 vota; Alban Hyseni me numër rendor 57, me 7.767 vota; Arta Baraliu me numër rendor 69, me 7.674 vota; Fitim Haziri me numër rendor 94, me 7.542 vota; Eman Rrahmani me numër rendor 109, me 7.044 vota.

24. Sipas këtij interpretimi ligjor të dispozitës së lartcekur të bërë nga KQZ, që përcakton se me radhë për zëvendësim vjen *"kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini"*, janë tejkaluar nga radha për zëvendësim kandidatja e gjinisë femërore, Tinka Kurti me numër rendor 30, me 7.655 vota dhe kandidatja tjetër e gjinisë femërore Drita Millaku, me numër rendor 36, me 7.063 vota, të cilat në listën e certifikuar nga KQZ më 27 nëntor 2019, kanë më shumë vota se kandidati Eman Rrahmani me numër rendor 109, me 7.044 vota.

25. Më 11 shkurt 2020, parashtrueset e kërkesës (Tinka Kurti dhe Drita Millaku), kandidate për deputete nga radhët e LVV, ndaras kanë paraqitur apel në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (në tekstin e mëtejmë: PZAP), kundër vendimit të KQZ-së [Nr.Prot. 102/A-2020 të 7 shkurtit 2020], duke theksuar se përzgjedhja e kandidatëve për zëvendësim të deputetëve të larguar është interpretim ligjor krejtësisht i gabueshëm, kundërkushtetues dhe i kundërligjshëm.

26. Më 13 shkurt 2020, PZAP përmes Vendimeve [Anr. 35/2020] dhe [Anr. 36/2020], refuzoi si të pabazuar apelet e parashtrueses së parë (Tinka Kurti) dhe parashtrueses së dytë (Drita Millaku), me arsyetimin vijues:

> *"PZAP, konstaton se pretendimet e parashtruara në apel janë të pabazuara, dhe si të tilla i refuzoj për faktin se vendimi KQZ-së, me Nr.Prot. 102/ A-2020 i datës 07.02.2020, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi që zëvendësimet për anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës bëhen duke marrë parasysh kandidatin e radhës të njëjtës gjini dhe të njëjtit subjekt politik, ashtu si është vepruar edhe në rastin konkret. Prandaj çdo pretendim në ankesë lidhur me shkelje të ligjit nuk qëndron."*

27. Kundër vendimeve të lartcekura të PZAP-it, parashtrueset e kërkesës parashtruan apelet përkatëse individuale pranë Gjykatës Supreme, duke propozuar që vendimet e PZAP-it të ndryshoheshin, ashtu që

KQZ-ja të rishqyrtojë vendimin përkatës lidhur me mos emërimin e tyre si deputete të Kuvendit.

28. Më 18 shkurt 2020, PZAP parashtroi në Gjykatën Supreme dy përgjigje në ankesë ku kundërshtoi në tërësi apelet e lartpërmendura të parashtrueseve të kërkesës, duke propozuar që të njëjtat të refuzohen si të pabazuara, ndërsa vendimet e lartpërmendura të PZAP-it të vërtetohet si të ligjshme.

29. Më 19 shkurt 2020, Gjykata Supreme nxori dy vendime lidhur me ankesat e parashtrueseve të kërkesës. Përmes Aktvendimit [AA. nr.4/2020] u refuzua si e pabazuar apeli i parashtrueses së parë (Tinka Kurti) e paraqitur kundër Vendimit të PZAP-it [A.nr. 35/2020] të 13 shkurtit 2020; ndërkaq, përmes Aktvendimit [AA.nr.3/2020] u refuzua si e pabazuar apeli i parashtrueses së dytë (Drita Millaku) e paraqitur kundër Vendimit të PZAP-it [A.nr. 36/2020] të 13 shkurtit 2020.

30. Në mes tjerash, Gjykata Supreme, në të dy Aktvendimet e lartcekura që janë identike në pjesën e arsyetimit, theksoi me sa vijon:

"Gjykata Supreme pranon në tërësi si të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it lidhur me refuzimin si të pabazuar të apelit të [Tinka Kurtit/Drita Milakut], *kandidate për deputete nga subjekti politik Lëvizja Vetevendosje, pasi që vendimi i kontestuar i PZAP-it është në tërësi i bazuar në dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Pergjithshme në Republikën e Kosovës.*

Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi edhe një herë të gjitha pretendimet e apelit të paraqitura kundër vendimit të PZAP me të cilat pretendohet se vendimi i PZAP-it është krejtësisht i gabueshëm, diskriminues, i kundërligjshëm dhe kundër kushtetues, dhe gjeti se pretendimet e tilla janë të pabazuara, kjo për faktin se vendimi i kontestuar i PZAP-it, edhe sipas bindjes së Gjykatës Supreme, nuk është i gabueshëm, diskriminues, i kundërligjshëm dhe kundër kushtetues, kjo nga se në dispozitën e lartpërmendur ligjore nga neni 112.2 pika a, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në fakt është paraparë formula e zëvendësimit të deputetëve, mandati i të cilëve ka përfunduar me marrjen e posteve në Qeveri të Republikës së Kosovës, kështu që në këtë dispozitë është paraparë klauzola respektivisht mënyra e zëvendësimit të këtyre deputetëve me deputet tjerë nga i njëjti subjekt politik dhe sipas gjinisë së njëjtë, kështu që kësaj zgjidhjeje ligjore, dhe kësaj formule të paraparë me ligj, nuk mund t'i shmanget tani për tani as KQZ-ja, as PZAPi, e as Gjykata Supreme e Kosovës. Përndryshe, është

supozim se ligjet janë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, andaj duhet zbatuar ashtu siç janë deri sa nga Gjykata Kushtetuese të konstatohet se një ligj apo ndonjë dispozitë ligjore e tij është në kundërshtim me Kushtetutën, andaj nuk mund të thuhet se zgjidhja ligjore e paraparë me nenin 112.2 pika a, të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës është kundër kushtetuese. Sipas kësaj zgjidhjeje ligjore deri më tani çdo herë është bërë zëvendësimi i deputetëve nga radhët e gjinisë së njëjtë, e jo sipas numrit të votave pa marrë parasysh gjininë, ashtu siç apeluesja pretendon, kështu që kësi soji është e ndërtuar një praktikë e ligjshme nga ana e KQZ, e bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, dhe e pranueshme deri më tani nga të gjitha subjektet politike dhe kandidatët për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, andaj as që mund të flitet për vendimin e KQZ-së dhe të PZAP-it si vendim diskriminues, të kundërligjshëm dhe kundër kushtetues."

31. Pas vendimmarrjes së Gjykatës Supreme, zëvendësimi i deputetëve për Kuvend është bërë bazuar në vendimmarrjen e KQZ-së dhe PZAP-it, siç edhe është konfirmuar nga Gjykata Supreme.

32. Përmes kërkesave KI45/20 dhe KI46/20, parashtrueset e kërkesës kontestojnë para kësaj Gjykate kushtetutshmërinë e dy Aktvendimeve të lartcekura të Gjykatës Supreme.

Pretendimet e parashtrueseve të kërkesës

33. Parashtrueset e kërkesës pretendojnë që Aktvendimet e Gjykatës Supreme [AA.nr.4/2020 dhe AA.nr.3/2020] të 19 shkurtit 2019, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 45 [Të drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

34. Për sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 24, në lidhje me nenit 7 dhe nenin 55 të Kushtetutës, parashtrueset e kërkesës e ndërtojnë rastin mbi pretendimin për diskriminim gjinor të kandidatëve për deputetë. Ato pretendojnë që interpretimi i nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është në kundërshtim me (i) Ligjin nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore; dhe (ii) Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, të cilat janë norma të karakterit *lex specialis* në raport me barazinë gjinore dhe diskriminimin.

35. Parashtrueset e kërkesës theksojnë se vendimet e kontestuara janë kundër kushtetuese, sepse cenojnë dy parimet kryesore kushtetuese, parimin e mosdiskriminimit dhe parimin e proporcionalitetit. Rrjedhimisht, parashtrueset e kërkesës theksojnë që vendimi i KQZ-së qartazi cenon parimin e mosdiskriminimit sipas kuptimit të paragrafit 2 të nenit 24 të Kushtetutës, ku përcaktohet se *"Askush nuk mund të diskriminohet në bazë [...] gjinisë, [...] ose ndonjë statusi tjetër personal.*" Sipas parashtrueseve të kërkesës, kemi të bëjmë me një rast klasik të diskriminimit në bazë të gjinisë, të kandidatëve për deputetë.

36. Interpretimi i nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, që përcakton se me radhë për zëvendësim vjen "*kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini"*, është i gabueshëm sepse është vetëm interpretim tekstual, i reduktuar vetëm në rrethanorin e shkakut *"i të njëjtës gjini"*, që domosdo sjellë pasoja të caktuara, e që shprehen në cenimin e të drejtës së garantuar kushtetuese sipas nenit 24.2 të Kushtetutës *"Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal."* Interpretimi i tillë gjuhësor, si mënyrë e interpretimit të ngushtë apo restriktiv, është tërësisht i gabuar në rastin konkret, sepse është në kundërshtim të plotë me frymën dhe qëllimin e të drejtës në Republikën e Kosovës dhe në normat ndërkombëtare në lidhje me votën, demokracinë dhe barazinë gjinore.

37. Parashtrueset e kërkesës pretendojnë që interpretimi i dispozitës së lartpërmendur të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është në kundërshtim me (i) Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore dhe (ii) Ligjin 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, të cilat janë norma të karakterit *lex specialis*, në raport me barazinë gjinore dhe diskriminimin.

38. Për sa i përket mospërputhjes së dispozitës së lartpërmendur me (i) Ligjin për Barazi Gjinore, sipas parashtrueseve të kërkesës ligjvënësi, jo vetëm që ka përcaktuar në mënyrë shprehimore masat për parandalimin e diskriminimit gjinor, por me kërkesën *"për përfaqësim të barabartë të femrave dhe meshkujve"* me qëllim *të "arritjes së barazisë gjinore",* njëkohësisht ka përcaktuar po aq qartë dhe pa kurrfarë dykuptimësie, duke i saktësuar në mënyrë sasiore dhe ligjore masat e veçanta për arritjen e qëllimit madhor: *"përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini*," (Neni 6, paragrafi 8). Rrjedhimisht, paragrafi 2 i nenit 5 [Masat e përgjithshme

për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore] përcakton që: *"Çdo dispozitë, e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji shfuqizohet"*.

39. Parashtrueset e kërkesës gjithashtu vënë theksin tek neni 6 [Trajtimi i ndryshëm i përligjur] i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, sipas së cilit asnjë dispozitë, kriter ose praktikë *"nuk konsiderohet diskriminim dallimi në trajtim [...]"* nëse një i tillë *"[...] është e justifikuar nga një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar"*. Në këtë kuptim, për arritjen e qëllimit madhor, barazisë gjinore, madje edhe duke përligjur trajtimin e ndryshëm që nuk konsiderohet diskriminim, neni 6 [Masat e veçanta] i Ligjit për Barazi Gjinore, ka përcaktuar *"masa të veçanta të përkohshme"* të cilat duhet të ndërmerren nga institucionet publike *"me qëllim të përshpejtimit të realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi"*. Rrjedhimisht, masa të tilla të veçanta mund të përfshijnë *"kuotën për të arritur përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve;"* (neni 6, paragrafi 2, pika 2.1.), që ligjvënësi shprehimisht e ka kodifikuar qartë si *"Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike [...]"*, "përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse," (neni 6, paragrafi 8) e që arrihet atëherë dhe vetëm atëherë kur sigurohet *"[...] përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini*".

40. Sipas parashtrueseve të kërkesës Vendimi i KQZ-së [Nr. 102/A-2020], i 7 shkurtit 2020 i ndërlidhur edhe me vendimet e tjera të kontestuara, paraqet interpretim të gabueshëm të një norme ligjore, duke e zhveshur të njëjtën nga thelbi normativ. Po ashtu, theksojnë që paragrafi 1 i nenit 27 (Kuotat Gjinore), i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, më gjithë mangësitë gjuhësore, përcakton qartë se: "*Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra*"; Shprehja ligjore e kuantifikuar "[...] së paku tridhjetë (30 %) përqind paraqet një kufi minimal të përfaqësimit gjinor në institucionet publike (kuotat gjinore), përfshirë edhe Kuvendin. Kjo nënkupton detyrimin ligjor që përfaqësimi minimal gjinor, qoftë i grave apo i burrave, edhe në Kuvend, nuk mund të jetë nën tridhjetë (30 %) për qind. Pra, qartazi, 30% paraqet kufirin minimal të përfaqësimit gjinor, por jo kufirin më të lartë të përfaqësimit. Rrjedhimisht vendimi i KQZ-së [Nr. 102/A-2020] i 7 shkurtit 2020, për Rekomandim e zëvendësimit të deputetë/e-ve, në rastin konkret të deputeteve gra (Tinka Kurti dhe Drita Millaku), e bën pikërisht të kundërtën e normës, duke e interpretuar si kufi maksimal të

përfaqësimit gjinor - të grave në Kuvend, dhe duke i eliminuar në rastin konkret dy kandidate gra me numër më të madh të votave në listën e kandidatë/e-ve të LVV-së, në favor të një *"kandidati të ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini"*. Rrjedhimisht, ky është interpretim diskriminues i një norme ligjore dhe njëkohësisht interpretim i gabueshëm i konceptit kushtetues të diskriminimit.

41. Parashtrueset e kërkesës duke u referuar në nenin 53 të Kushtetutës, thirren edhe në praktikë gjyqësore të Gjykatës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), duke cituar rastin *Thimmenos kundër Greqisë,* kërkesa nr. 34369/97, e 6 prillit 2000, paragrafi 44, ku thekson *"[e] drejta [...] për të mos u diskriminuar ... shkelet kur Shtetet trajtojnë në mënyre jo të barabartë persona në situata të ngjashme pa dhënë një justifikim objektiv dhe te arsyeshëm"*.

42. Parashtrueset e kërkesës theksojnë që në mënyrë që një justifikim i tillë të jetë *"objektiv dhe i arsyeshëm"*, ai duhet të plotësojë dy kushte të mëtejshme: (1) duhet të ketë një *"qëllim legjitim"* për pabarazinë në fjalë dhe (2) duhet të ketë një *"lidhje të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjetit të përdorur dhe qëllimit të synuar"* (shih rastin e GJEDNJ-së: "*Çështja "në lidhje me disa aspekte të ligjeve për përdorimin e gjuhëve në arsim në Belgjikë" kundër Belgjikës*, kërkesat Nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63, 2126/64, Aktgjykim i 23 korrikut 1968, paragrafi 10; shih gjithashtu rastin *X dhe të tjerët kundër Austrisë*, kërkesa nr. 19010/07, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 shkurtit 2013, paragrafi 98).

43. Përfundimisht parashtrueset e kërkesës theksojnë se kushtetutshmëria e tejkalimit të saj duhet të vlerësohet sipas disa hapave të caktuar analitikë, e ku propozojnë që të vlerësohet në bazë të testit të proporcionalitetit të nenit 55 të përcaktuar në rastin KO131/12, me parashtrues *Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 15 prillit 2013, paragrafi 127. Parashtrueset e kërkesës theksojnë që neni 55, paragrafi 4 i Kushtetutës, përcakton se: *"Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik [...] e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes [...] raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet"*. Po ashtu, paragrafi 2 i nenit 55, përcakton se: *"Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi"*.

44. Po ashtu, ky vendim i KQZ-së, dhe vendimet e tjera të kontestuara, qartazi cenojnë parimin e proporcionalitetit sipas kuptimit të paragrafit 2 të nenit 55 [Kufizimi i te Drejtave dhe Lirive Themelore], të Kushtetutës, që përcakton qartazi se *"Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetute, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi"*. Mirëpo, edhe në rast të ndonjë kufizimi eventual, *"vetëm me ligj"* (po aty, paragrafi 1), në instancë të fundit, pa marrë parasysh rrethanat, çdo *"Kufizim i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar"* (po aty, paragrafi 5). Sipas parashtrueseve të kërkesës, KQZ përmes Vendimit të saj, përveç që ka bërë kufizim joproporcional, pa pasur ndonjë qëllim legjitim për të cilin është bërë kufizimi, kufizimi mohon edhe esencën e së drejtës së garantuar, të drejtën e votës.

45. Përfundimisht, sipas parashtrueseve të kërkesës, interpretimi i vetëm i drejtë, lidhur me nenin 112 paragrafi 2.a të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, bazuar në të gjitha normat kushtetuese, ligjore dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cekura në paragrafët e lartcekur të kësaj kërkese: *"kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini"*, është vetëm ai/ajo kandidat që i takon gjinisë së nënpërfaqësuar sipas kuotës gjinore minimale prej 30%. Ky është detyrim kushtetues e ligjor për cilindo institucion shtetëror, përfshi këtu edhe Kuvendin. Në rastin konkret, sipas nenit 112 paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të dy gjinitë kanë arritur kuotën ligjore të përfaqësimit minimal prej 30%. Prandaj zëvendësimi në këtë rast bëhet vetëm sipas radhitjes në listën e kandidatëve sipas votave të marra në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, të certifikuara me 27 nëntor 2019 nga KQZ. Rrjedhimisht, në listën e pritjes së kandidatë/eve për zëvendësim nga lista e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, sipas votave janë Tinka Kurti me numër rendor 30, me 7.655 vota dhe Drita Millaku, me numër rendor 36, me 7.063 vota, para kandidatit Eman Rrahmani me numër rendor 109, me 7.044 vota.

46. Në anën tjetër, për sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 7 të Kushtetutës, parashtrueset e kërkesës e ndërtojnë rastin mbi pretendimin se ky vendim i KQZ-së për zëvendësimin e deputetëve/eve me kandidatë/et e radhës që bazë përcaktuese ka gjininë e kandidatë/eve, duke përjashtuar gjegjësisht kufizuar të drejtën e fituar përmes shprehjes së lirë të vullnetit politik - votës, kandidateve të caktuara në radhë të pritjes, është në kundërshtim të plotë, të drejtpërdrejtë dhe të pamohueshëm me paragrafin 2 të nenit 7, të Kushtetutës, që garanton se: *"Republika e Kosovës siguron*

barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore". Ky cenim i njërës ndër vlerat *"themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë"*, përbën shkelje të rëndë të Kushtetutës.

47. Për sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 45 të Kushtetutës, parashtrueset e kërkesës e ndërtojnë rastin mbi pretendimin se interpretimi i paragrafit 2 të nenit 112 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, që përcakton se me radhë për zëvendësim vjen *"kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini"*, është i gabueshëm sepse duke reduktuar interpretimin tekstual vetëm në rrethanorin e shkakut *"i të njëjtës gjini"*, cenon të drejtën e garantuar kushtetuese sipas paragrafit 1 të neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] që garanton se: "*çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor"*. Interpretimi i tillë i nenit 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, është tërësisht i gabuar në rastin konkret, sepse është në kundërshtim të plotë me frymën dhe qëllimin e së drejtës së garantuar kushtetuese të qytetarëve në Republikën e Kosovës për të gëzuar *"të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet,"* përmes deformimit në mënyrë arbitrare të vullnetit të shprehur nëpërmjet të drejtës për të zgjedhë - votës, duke mohuar po aq në mënyrë arbitrare të drejtën e qytetares/it që të zgjedhet, pa e kufizuar këtë të drejtë me vendim gjyqësor. Asnjëra nga instancat vendimmarrëse në këtë rast (Gjykata Supreme, PZAP, KQZ), nuk ka ofruar asnjë akt gjyqësor që Tinka Kurtit dhe Drita Millakut i kufizon këtë të drejtë.

48. Po ashtu, parashtrueset e kërkesës theksojnë se Aktvendimet e kontestuara në kontekst të interpretimit të nenit 112.2 (a) është në kundërshtim edhe me qëndrimin e vetë Gjykatës Supreme e cila në Aktvendimin [AA. nr. 34/2017], të 17 nëntorit 2017 konstaton se: *"pajtueshmëria me kuotën gjinore nënkupton përfaqësimin e minimum 30% të femrave dhe pasi përfaqësimi është 50% në këtë rast specifik, kjo nuk do të thotë se është në kundërshtim me LZP"*, (Rasti i Gjykatës nr. KI142/17, me parashtrues *Mentor Jashari*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 prillit 2018, paragrafi 38). Këtë interpretim të Gjykatës Supreme, parashtrueset e kërkesës e konsiderojnë arsyetim të drejtë ligjor dhe të mjaftueshëm.

49. Përfundimisht, parashtrueset e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të shfuqizojë Aktvendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme, sepse të

njëjtit: (i) paraqesin shkelje të paragrafit 2 të nenit 7 [Vlerat], të Kushtetutës; (ii) cenojnë parimin e proporcionalitetit sipas kuptimit të paragrafit 2 të nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]; (iii) cenojnë parimin e mosdiskriminimit nga paragrafi 2 i nenit 24 [Barazia para Ligjit]; si dhe (iv) janë nxjerrë në kundërshtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, [A.nr.193/2020], Tinka Kurti në lidhje me kërkesën për Aktvendimin AA.nr.4/2020 të znj. Tinka Kurti kundër Gjykatës Supreme të Kosovës

50. Avokati i Popullit i paraqiti Gjykatës një Mendim Juridik në cilësinë e mikut të Gjykatës (*Amicus Curiae*), i cili ka për qëllim t'i ofrojë qëndrimet e tij lidhur me çështjet e ngritura në kërkesën KI46/20 që kanë të bëjnë me barazinë dhe mbrojtjen nga diskriminimi me rastin e zëvendësimit të kandidateve të radhës për deputetë të Kuvendit. Siç u shpjegua në procedurën para Gjykatës, ky Mendim Juridik është pranuar nga Gjykata dhe është bërë pjesë përbërëse e dosjes së rasteve KI45/20 dhe KI46/20.

51. Avokati i Popullit thekson se në bazë të paragrafit 1 të nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, paragrafit 9 të nenit 16 [Kompetencat] të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, nënparagrafit 13, paragrafit 2, të nenit 9 [Avokati i Popullit] të Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe nenit 13 [Avokati i Popullit] të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, e autorizojnë avokatin e popullit që të veprojë në cilësinë e mikut të Gjykatës.

52. Avokati i Popullit vlerëson se një nga shembujt e zbatimit të parimeve interpretuese të ligjit ka të bëjë me raportin ndërmjet (i) Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe (ii) Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me kërkesat e tyre përkatëse për përfaqësim gjinor mes përfaqësuesve të zgjedhur.

53. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit i referohet paragrafit 1 të nenit 27 të (ii) Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i cili përcakton se: *"Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) përqind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) përqind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë"*. Megjithatë, paragrafët 7 dhe 8 të nenit 6 të Ligjit për

Barazi Gjinore paraqesin një kërkesë më të rreptë: *"Organet legjislative (..) janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji."*; duke theksuar: *"Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse"*.

54. Në vijim, Avokati i Popullit vlerëson se sipas parimit *lex specialis*, kërkesa më e rreptë e Ligjit për Barazi Gjinore gëzon përparësi në raport me atë më pak të rreptë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Po ashtu, edhe parimi *lex posterior* është me relevancë në këtë rast, pasi që Ligji për Barazi Gjinore u miratua nga Kuvendi më 28 maj 2015, ndërsa Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme u miratua, më 5 qershor 2008. Në bazë të kësaj, mund të konsiderojmë se kërkesa e përcaktuar në Ligjin për Barazi Gjinore reflekton më saktë vullnetin e përfaqësuesve të popullit në lidhje me këtë çështje, prandaj duhet të gëzojë përparësi në raport me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

55. Sipas Avokatit të Popullit, dispozita e përkufizuar në pikën a) të paragrafit 2 të nenit 112 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nënkupton se zëvendësimi duhet të bëhet vetëm me kandidatin e gjinisë së njëjtë, pa marrë parasysh se kandidati tjetër i gjinisë tjetër ka numër më të madh të votave. Rrjedhimisht Avokati i Popullit vëren se kjo dispozitë nuk është në pajtim me dispozitën e nenit 45 të Kushtetutës.

56. Arsyeja e parë sipas Avokatit të Popullit qëndron në atë se zëvendësimi me kandidatin e ligjshëm sipas gjinisë së njëjtë, e cenon të drejtën e personit për tu zgjedhë, sepse në rastin konkret, zëvendësimi i kandidatëve sipas nenit 112, paragrafit 2 të Ligjit për Zgjedhjet, ka rezultuar me fitimin e të drejtës së kandidatit që ka më pak vota se sa kandidatet Tinka Kurti me 7655 vota dhe Drita Millaku me 7063 vota (rrjedhimisht kandidati Eman Rrahmani ka 611 vota më pak se znj. Tinka Kurti dhe 19 vota më pak se znj. Drita Millaku). Pra, sipas këtij rregulli dy kandidatet gra (parashtrueset e kërkesës) nuk kanë arritur ta fitojnë të drejtën për tu zgjedhur anëtare të Kuvendit të Kosovës edhe përkundër faktit se kanë numër më të madh të votave se sa kandidati i cili është zëvendësuar sipas nenit 112, paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet. Avokati i Popullit konsideron se një formulim i tillë i jep përparësi vetëm gjinisë së kandidatit, gjë që bie në kundërshtim me rregullin sipas të cilit kandidati i cili ka numër më të madh të votave, fiton të drejtën për tu bërë anëtar i Kuvendit të Kosovës.

57. Arsyeja e dytë të cilën e potencon Avokati i Popullit qëndron në atë që zëvendësimi i kandidatit të ligjshëm sipas gjinisë së njëjtë e cenon edhe të drejtën për të zgjedhë, pasi që nuk janë marrë parasysh 611 vota të kandidates Tinka Kurti, që i bie se nuk janë marrë parasysh 611 vota të qytetarëve të Kosovës. Për më tepër, Avokati i Popullit vëren se edhe kandidatja tjetër në radhë sipas numrit të votave nuk ka mundur ta gëzojë të drejtën për tu bërë anëtare e Kuvendit të Kosovës, edhe pse ka më shumë vota se kandidati i cili është zëvendësuar sipas nenit 112, paragrafit 2 të Ligjit për Zgjedhjet (Drita Millaku, 19 vota më tepër se kandidati Eman Rrahmani).

58. Avokati i Popullit thekson se përmbajtja aktuale e nenit 112, paragrafit 2 të Ligjit për Zgjedhjet mund të duket në parim si garanci e ekzistimit të gjinisë më pak të përfaqësuar (kuota gjinore). Mirëpo, sa i përket kuotës gjinore, Avokati i Popullit vlerëson se kuota është garanci ligjore, e cila nuk mund të vihet në pyetje në asnjë rast, për shkak se pa marrë parasysh zëvendësimet e kandidatëve, domosdoshmërisht duhet që të plotësohet kushti që së paku 30% të vendeve të siguruara t'i ndahen kandidatëve të gjinisë më pak të përfaqësuar. Këtë vlerësim, Avokati i Popullit e mbështet në përcaktimet e Ligjit për Zgjedhjet, përkatësisht neni 111 [Ndarja e Vendeve], paragrafi 6, sipas të cilit *"Nëse pas ndarjes se vendeve të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë se paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i radhës i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidate, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%".*

59. Më tej, Avokati i Popullit vëren se në rastet kur kuota prej 30% është përmbushur, atëherë radhitja e kandidatëve, duke përfshirë edhe zëvendësimin e tyre, duhet të bëhet sipas përcaktimit të nenit 111 [Ndarja e Vendeve], paragrafi 4, të Ligjit për Zgjedhjet, sipas së cilit "*...Listat me kandidatë rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat*". Rrjedhimisht sipas këtij përcaktimi, në momentet kur kuota gjinore është përmbushur, renditja dhe rirenditja e kandidatëve (pa dallim gjinie) duhet të bëhet sipas numrit të votave që ata i kanë fituar, dhe çdo renditje tjetër rezulton me shkeljen e të drejtës kushtetuese për të zgjedhë, dhe për tu zgjedhur.

60. Po ashtu, sipas Avokati të Popullit ka mospërputhje brenda neneve të Ligjit për Zgjedhjet, përkatësisht, në mes nenit 111, paragrafi 4, me nenin 112, paragrafi 2 (pika a dhe b), dhe mospërputhjet e tilla sjellin

konfuzion tek organet zbatuese të këtij ligji, gjë që mund të rezultojë me nxjerrjen e vendimeve me të cilat shkelen të drejtat e njeriut.

61. Avokati i Popullit vlerëson se Gjykata Supreme me rastin e nxjerrjes së Aktvendimit AA nr. 4/2020, të 19 shkurtit 2020 ka përdorur një qasje të ngushtë, duke u fokusuar vetëm tek zbatimi i nenit 112, paragrafi 2 (pika a), duke mos marrë parasysh garancitë kushtetuese për barazi para ligjit të përcaktuar me nenin 24 të Kushtetutës dhe për të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, të përcaktuara me nenin 45 të Kushtetutës.

62. Përfundimisht, Avokati i Popullit vlerëson se qëllimi i nenit 112, paragrafi 2 (pika a) duket se është për ta mbajtur një *status quo* të kuotës gjinore prej 30% për gjininë pakicë në Kuvend, një herë kur ajo arrihet. Kjo dispozitë, duke pasur parasysh kuotën gjinore prej 30% parqet një pengesë në arritjen e përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave e që sipas Ligjit për Barazi Gjinore: *"Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse"* (neni 6, paragrafi 2, nën-paragrafi 8). Për më shumë, Avokati i Popullit vlerëson se nenin 112, paragrafi 2 (pika a) do të kishte kuptim vetëm nëse kuota gjinore është 50% për secilën gjini.

Dispozita relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 7 [Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.

4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar.

Ligji Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

Neni 27
Kuotat Gjinore

27.1 Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë.

27.2 Kjo dispozitë nuk aplikohet te listat e përbëra nga një apo dy kandidatë.

Neni 111
Ndarja e vendeve

[...]

111.4 Të gjitha votat e fituara nga kandidatët që janë në listën e hapur të subjektit politik numërohen ndaras. Listat me kandidatë rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat.

111.5 Vendet që i ndahen subjektit politik në paragrafin 2 të këtij neni u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur të kandidatëve të subjektit politik në paragrafin 4 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listë sipas një renditje zbritëse, deri në mbarim të vendeve që i ndahen subjektit politik. Vendet shtesë që u ndahen subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet tjera joshumicë në Kosovë sikurse në paragrafin

3 të këtij neni u ndahen kandidatëve pasues nga lista e rirenditur nga paragrafi 4 i këtij neni e kandidatëve të subjektit politik.

111.6 Nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i radhës i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%."

Neni 112
Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendit

112.1 Vendet e shpërndara ne përputhje me ketë Ligj mbahen personalisht nga kandidatet e zgjedhur dhe jo nga subjekti politik. Mandati i anëtarit nuk do të ndryshohet apo ndërpritet para se të përfundoj mandati përveç ne rastet vijuese:

a) dënimi i anëtarit për vepër penale për të cilën ai apo ajo është dënuar me burgim sikurse parashikohet me anë të nenit 69.3 (6) të Kushtetutës;

b) dështimi i anëtarit që të marrë pjesë në seancat e Kuvendit apo të Komiteteve për gjashtë (6) muaj radhazi, anëtar i të cilave ai apo ajo janë, përveç nëse jepet ndonjë arsye bindëse në pajtim me Rregullat e Kuvendit;

c) humbja e mandatit të anëtarit, sipas nenit 29 të këtij ligji;

d) vdekja e anëtarit;

e) paaftësia mendore ose fizike e anëtarit, e përcaktuar me anë të vendimit përfundimtar gjyqësor, apo

f) dorëheqja e anëtarit.

112.2 Një anëtar i Kuvendit të Kosovës mandati i të cilit përfundon në pajtim me nenin 112.1 zëvendësohet si vijon:

a) nga kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini i cili ka fituar numrin më të madh të votave të listës së riorganizuar të kandidatëve të Subjektit Politik në emër të së cilës garoi anëtari;

b) nëse nuk ka ndonjë kandidat tjetër të ligjshëm me gjini të njëjtë nga lista e kandidatëve, nga kandidati i radhës i cili ka fituar numrin më të lartë të votave në listën e kandidatëve;

Ligj për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

Neni 8

2. Neni 111 i ligjit në fuqi, paragrafi 6. riformulohet si në vijon:

111.6 Nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuara për kandidatët në listën e një subjekti politik, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të ndarë për atë subjekt politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga kandidati i radhës i gjinisë pakicë në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%. Ky paragraf nuk zbatohet ndaj ndarjes së vendeve nga lista që përbëhet prej një (1) apo dy (2) kandidatëve.

Ligji Nr. 05/L -020 Për Barazi Gjinore

Neni 5
Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore

[...]

2. Çdo dispozitë, e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji shfuqizohet.

Neni 6
Masat e veçanta

1. Institucionet publike marrin masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përshpejtimit të realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi.

2. Masat e veçanta mund të përfshijnë:

2.1. kuotën për të arritur përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve;

[...]

8. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.

Neni 13
Avokati i Popullit

Avokati i Popullit është institucion i barazisë që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.

Ligji Nr.05/L-021 Për Mbrojtjen Nga Diskriminimi

Neni 6
Trajtimi i ndryshëm i përligjur

Pavarësisht nga nenet 3 dhe 4 të këtij Ligji, nuk konsiderohet diskriminim dallimi në trajtim i cili bazohet në dallimet e dhëna në bazat e nenit një (1) të këtij Ligji, mirëpo i cili si i tillë paraqet karakteristikën reale dhe përcaktuese me rastin e punësimit, qoftë për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale ose të vetë kontekstit në të cilin kryhen punët e caktuara profesionale, nëse ajo dispozitë, kriter ose praktikë është e justifikuar nga një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar.

Neni 9
Avokati i Popullit

[...]

2. Avokati i Popullit ka këto kompetenca:

2.13. Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi;

Pranueshmëria e kërkesës

63. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

64. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës të cilët përcaktojnë se:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

65. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtrueset e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

66. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata vëren se parashtrueset e kërkesës i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, pasi që janë palë të autorizuara, kontestojnë akte të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Aa.nr.4/2020] e 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme dhe Aktvendimin [Aa.nr.3/2020] e 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtrueset e kërkesës gjithashtu i kanë sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ato pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe i kanë dorëzuar kërkesat në pajtim me afatet e përcaktuara ne nenin 49 të Ligjit.

67. Rrjedhimisht, bazuar në ato që u thanë më lart, Gjykata e shpallë kërkesën të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

Meritat e kërkesës

68. Gjykata rikujton se parashtrueset e kërkesës pretendojnë që atyre u janë shkelur të drejtat e tyre të mbrojtura me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 45 [Të drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

69. Si përmbledhje, Gjykata rikujton se parashtrueset e kërkesës, në thelb, pretendojnë se vendimmarrja e KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme është kundërkushtetuese për faktin se:

(i) interpretimi i nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nga ana tri institucioneve paraprake (KQZ, PZAP dhe Gjykatë Supreme), qartazi cenon parimin e mosdiskriminimit sipas kuptimit të paragrafit 2 të nenit 24 të Kushtetutës dhe se një interpretim që iu është bërë asaj dispozite ligjore është në kundërshtim edhe me Kushtetutën, Ligjin nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore dhe Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga diskriminimi;

(ii) vendimet e kontestuara sipas mënyrës së interpretimit të nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme cenojnë parimin e proporcionalitetit sipas kuptimit të paragrafit 2 të nenit 55 të Kushtetutës, kufizim ky që mohon edhe thelbin e një të drejte të garantuar, përkatësisht të drejtën për tu zgjedhur të garantuar me nenin 45 të Kushtetutës;

(iii) vendimet e kontestuara për zëvendësimin e deputetëve/eve me kandidatë/et e radhës që bazë përcaktuese ka *"gjininë"* e kandidatë/eve, duke përjashtuar të drejtën e fituar përmes shprehjes së lirë të vullnetit politik - votës, kandidateve të caktuara në radhë të pritjes, është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 7 të Kushtetutës si dhe nenin 45 të Kushtetutës.

70. Në këtë drejtim, Gjykata vë në pah se thelbi i çështjes së ngritur nga parashtrueset e kërkesës i referohet aspektit të *"barazisë para ligjit"* dhe *"të drejtës për tu zgjedhur"* në procesin e zbatimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme me rastin e zëvendësimit të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

71. Nga kjo rrjedh se ankesa kushtetuese e këtij rasti ka të bëjë me faktin: A është zbatuar neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nga ana e KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme, në përputhje me garancitë, vlerat dhe parimet e proklamuara me nenet 24 dhe 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së?

72. Për të dhënë përgjigje konkrete në këtë ankesë kushtetuese, Gjykata në vijim do të paraqes (i) parimet e përgjithshme të Kushtetutës dhe KEDNJ-së përkitazi me barazinë para ligjit dhe të drejtës për tu zgjedhur; (ii) përmbledhjet e opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias për barazi gjinore, në veçanti kuotave gjinore si masa të veçanta për të adresuar pabarazinë faktike në mes të gjinive në përfaqësim politik; si dhe, më pas, do të bëjë (iii) zbatimin e të gjitha këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret me qëllim të ofrimit të përgjigjes përfundimtare në këtë rast.

Parimet e përgjithshme që burojnë nga Kushtetuta dhe KEDNJ përkitazi me barazinë para ligjit dhe të drejtën për tu zgjedhur

73. Republika e Kosovës është përcaktuar për një rend kushtetues në të cilin barazia gjinore përbën një nga vlerat themelore. Kjo vlerë ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin demokratik të shoqërisë dhe jetësimin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave në jetën

politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore (shih nenin 7 të Kushtetutës).

74. Nevoja e krijimit të mundësive të barabarta krijon për shtetin detyrime pozitive për përdorim të instrumenteve dhe masave të ndryshme, duke përfshirë edhe normime ligjore, me qëllim të eliminimit të *pabarazive faktike* ndërmjet grave dhe burrave. Në kontekst të sigurimit të barazisë gjinore, me Ligjin e Zgjedhjeve të Përgjithshme është përcaktuar kuota gjinore e përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar në kuotën 30%. Çështja e gjinisë së nënpërfaqësuar në legjislacionin e aplikueshëm quhet *"gjini pakicë"*, pa përcaktuar se cila gjini është ajo specifikisht dhe kjo për faktin se në kohëra të ndryshme gjini pakicë mund të jetë njëra ose tjetra (lexo në këtë kontekst nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 27 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme).

75. Sipas Kushtetutës, shprehimisht parashihet që parimet e mbrojtjes së barabartë nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë (shih nenin 24.3 i Kushtetutës). Masat e tilla të veçanta paraqesin instrumente me të cilat shteti, respektivisht Republika e Kosovës, zhvillon politikën e mundësive të barabarta, si dhe zbut ose eliminon *pabarazinë faktike*. Të tilla masa mund të zbatohen për kohë të pacaktuar, mirëpo vetëm deri në realizimin e qëllimit për të cilin edhe janë vendosur.

76. Në anën tjetër, për sa i përket nenit 45 të Kushtetutës, Gjykata nënvizon se kjo normë kushtetuese garanton të drejtën për të zgjedhur (aspektin aktiv të votës), si dhe të drejtën për t'u zgjedhur (aspektin pasiv të votës) (shih, me gjerësisht për këto dy aspekte, rastet e Gjykatës Kushtetuese ku janë trajtuar çështje të ndryshme në lidhje me nenin 45 të Kushtetutës: KI01/18, me parashtrues *Gani Dreshaj dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2019; KI48/18, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2019). Më specifikisht, aspekti pasiv i votës që reflektohet në të drejtën për tu zgjedhur, paraqet një të drejtë specifike relevante në këtë rast konkret, i takon kandidatëve si individë, përkatësisht si persona fizikë, të cilët garojnë në zgjedhje, në nivel lokal apo qendror, si dhe subjekteve politike, përkatësisht personave juridikë që garojnë në zgjedhje, në nivel lokal apo qendror.

77. Të drejtat e garantuara me nenit 45 të Kushtetutës dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së janë të drejta qenësore drejt krijimit dhe mbajtjes së themeleve të një demokracie efektive dhe të vlefshme që

udhëhiqet nga sundimi i ligjit. Megjithatë, këto të drejta nuk janë absolute. Si Kushtetuta, ashtu dhe KEDNJ, lejojnë një hapësirë për *"kufizime të nënkuptuara"* në të cilën fushë shteti ka margjinë të gjerë vlerësimi (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI207/19, parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, Aktgjykim i 10 dhjetor 2020, paragrafët 148-153, si dhe referencat e cituara aty; rastin e GJEDNJ-së, *Yumak dhe Sadak kundër Turqisë*, Aktgjykim i 8 korrikut 2008, paragrafi 109 dhe referencat e cituara aty).

78. GJEDNJ ka qartësuar se si nen me karakteristika të veçanta, neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk përmban një listë të qëllimeve legjitime të cilat do të justifikonin kufizimin e ushtrimit të së drejtës që garantohet me këtë nen. I njëjti gjithashtu nuk iu referohet "qëllimeve legjitime" të cilat në mënyrë shteruese janë të përcaktuara në nenet 8 deri 11 të KEDNJ-së. Si rezultat, GJEDNJ ka theksuar se shtetet janë të lira të thirren në *"qëllimet e tyre"* specifike kur kufizojnë ushtrimin e kësaj të drejte me kushtin që qëllimet e tilla të jenë: (i) në pajtim me parimin e sundimit të ligjit; dhe (ii) objektivave të përgjithshme të Konventës (shih rastin e Gjykatës KI207/19, cituar më lart, paragrafët 148-153 dhe referencat e cituara aty).

79. Në vijim, lidhur me interpretimin e garancive të mishëruara në nenet 24 dhe 45 të Kushtetutës, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së (me theks të veçantë rastit *Sejdić dhe Finci kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2009), në kontekst të zbatimit të neneve ekuivalente, respektivisht nenit 14 (Ndalimi i diskriminimit) të marrë në lidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

80. Neni 14 i KEDNJ-së plotëson dispozitat e tjera thelbësore të Konventës dhe Protokolleve të saj. Ky nen nuk vepron si i pavarur pasi ka efekt vetëm në lidhje me "gëzimin e të drejtave dhe lirive" të mbrojtura nga dispozitat e tjera. Megjithëse zbatimi i nenit 14 nuk paragjykon shkelje të atyre dispozitave - dhe në këtë masë është autonom, nuk mund të ketë vend për zbatimin e tij përveç nëse faktet në fjalë bien *"brenda fushës"* së një ose më shumë prej këtyre të fundit (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Sejdić dhe Finci kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2009, paragrafi 39; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 28 majit 1985, paragrafi 71; *Petrovic kundër Austrisë*, Aktgjykim i 27 marsit 1998, paragrafi 22; dhe *Sahin kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 8 korrikut 2003, paragrafi 85). Ndalimi i diskriminimit në nenin 14 shtrihet përtej gëzimit të të drejtave dhe lirive të cilat Konventa dhe Protokollet e saj kërkojnë që secili shtet t'i garantojë. Ky nen zbatohet

gjithashtu për ato të drejta shtesë që bien brenda fushës së përgjithshme të çdo neni të KEDNJ-së, për të cilin shteti ka vendosur të sigurojë vullnetarisht. Ky parim është i mirë bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (shih *rastin "Çështja "në lidhje me disa aspekte të ligjeve për përdorimin e gjuhëve në arsim në Belgjikë" kundër Belgjikës* (meritat), Aktgjykim i 23 korrikut 1968, paragrafi 9; *Stec dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dhjetor), paragrafi 40; dhe *EB kundër Francës,* Aktgjykim i 22 janarit 2008, paragrafi 48).

81. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, për qëllimet e nenit 14 të Konventës, një trajtim është diskriminues, nëse "*nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm"*, d.m.th nëse nuk ndjek një *"qëllim të legjitim"* ose nëse nuk ka një *"marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet"* (shih *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 28 majit 1985, Seria A nr. 94, fq. 35-36, paragrafi 72). GJEDNJ ka nënvizuar se Shtetet Kontraktuese gëzojnë një margjinë të caktuar vlerësimi nëse dhe në çfarë mase ndryshimet në situata të ngjashme arsyetojnë një trajtim të ndryshëm (shih rastin e GJEDNJ-së *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 11 qershorit 2002, paragrafi 39).

82. GJEDNJ gjithashtu ka theksuar se neni 14 i Konventës nuk ka ekzistencë të pavarur, por luan një rol të rëndësishëm duke plotësuar dispozitat e tjera të Konventës dhe Protokolleve të saj, pasi mbron individët, të vendosur në situata të ngjashme, nga çdo diskriminim në gëzimin e të drejtave të përcaktuara me dispozita të tjera. Kur kemi pretendime të cenimit të një dispozite thelbësore të Konventës në të cilën është mbështetur, si në vetvete ashtu edhe në lidhje me nenin 14, dhe është konstatuar një shkelje e veçantë e nenit substancial, nuk është përgjithësisht e nevojshme që Gjykata të shqyrtojë çështjen sipas nenit 14 gjithashtu, megjithëse pozicioni është ndryshe nëse një pabarazi e qartë e trajtimit në gëzimin e të drejtës në fjalë është një aspekt themelor i çështjes (shih rastin e GJEDNJ-së: *Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 22 tetorit 1981, Seria A nr. 45, f. 26, paragrafi 67, dhe *Chassagnou dhe të tjerët kundër Francës*, me nr. 25088/94, kërkesa nr. 28331/95 dhe kërkesa nr. 28443/95, paragrafi 89, KEDNJ 1999-III).

83. GJEDNJ shpeshherë ka nënvizuar që neni 14 thjesht plotëson dispozitat e tjera thelbësore të Konventës dhe Protokolleve të saj (shih rastet e GJEDNJ-së: *Molla Sali kundër Greqisë*, kërkesa nr. 20452/14, Aktgjykim i 19 dhjetorit, 2018, paragrafi 123; *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* kërkesa nr. 42184/05,

Aktgjykim i 16 marsit 2010, paragrafi 63; *EB kundër Francës*, kërkesa nr. 43546/02, Aktgjykim i 22 janarit 2008, paragrafi 47; *Marckx kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 6833/74, Aktgjykim i 13 qershorit 1979, paragrafi 32). Kjo do të thotë që neni 14 nuk ndalon diskriminimin si të tillë, por vetëm diskriminimin në gëzimin e "të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë". Me fjalë të tjera, garancia e dhënë nga neni 14 nuk ka ekzistencë të pavarur (Çështja "në lidhje me aspekte të caktuara të ligjeve për përdorimin e gjuhëve në arsim në Belgjikë" kundër Belgjikës ("çështja gjuhësore belge"), kërkesat nr. 1474/62; 1677/62; 1691/62; 1769/63; 1994/63; 2126/64, Aktgjykimi i 23 korrikut 1968 , paragrafi 9 te pjesa "Ligji"; *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lartë, paragrafi 63; *EB kundër Francës*, cituar më lartë, paragrafi 47) dhe se ky nen përbën një pjesë integrale të secilës prej neneve që përcaktojnë të drejtat dhe liritë (*çështja gjuhësore belge,* cituar më lartë, paragrafi 9 i pjesës "Ligji"; *Marckx kundër Belgjikës*, cituar më lartë, paragrafi 32; *Inze kundër Austrisë*, kërkesa nr. 8695/79, Aktgjykim i 28 tetorit 1987, paragrafi 36). Në praktikë, GJEDNJ gjithmonë shqyrton nenin 14 në lidhje me një dispozitë tjetër thelbësore të Konventës.

84. Përfundimisht, jo të gjitha ndryshimet në trajtim - ose dështimi për të trajtuar ndryshe persona në situata relativisht të ndryshme - përbëjnë diskriminim, por vetëm ato pa *"një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm"* (shih rastet e GJEDNJ-së: *Molla Sali kundër Greqisë*, kërkesa nr. 20452/14, Aktgjykim i 19 dhjetorit 2018, paragrafi 135; *Fabris kundër Francës*, kërkesa nr. 16574/08, Aktgjykim i 7 shkurtit 2013, paragrafi 56; *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, kërkesa nr. 57325/00, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 175; *Hoogendijk kundër Holandës*, kërkesa nr. 58641/00, Vendim për Papranueshmëri i 1 qershorit 2005).

85. Kur vendos çështjet e diskriminimit, GJEDNJ zbaton testin e mëposhtëm:

1. A ka pasur një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge ose relativisht të ngjashme - ose një dështim për të trajtuar ndryshe personat në situata relativisht të ndryshme?
2. Nëse po, a justifikohet objektivisht një ndryshim i tillë - ose mungesa e ndryshimit të tillë në trajtim? Në veçanti: a. A ndjek ai një qëllim legjitim? b. A janë mjetet e përdorura në mënyrë të arsyeshme proporcionale me qëllimin e ndjekur?

Përmbledhja e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias për Barazi Gjinore [CDL-PI(2016)007], OSBE/ODIHR dhe të tjera

86. Praktika ndërkombëtare tregon se masat e veçanta që vendosen në sisteme të ndryshme për adresim të pabarazive faktike në përfaqësim të gjinive - janë rregullime ligjore që kërkojnë një përqindje minimale të përfaqësimit të gjinisë pakicë. Si të tilla dhe përderisa i shërbejnë një qëllimi të tillë, këto masa të veçanta nuk duhet të konsiderohen si në kundërshtim me parimin e votimit të barabartë.

87. Disa legjislacione dhe praktika kombëtare të disa partive evropiane kanë shkuar një hap më tej për të paraqitur kuota si synim për të përmirësuar ekuilibrin gjinor ose, më drejtpërdrejt, për të arritur përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave në organin e zgjedhur. Përderisa këto praktika janë specifike për vendet dhe partitë politike, futja e masave për barazinë gjinore, gradualisht po bëhet trend dominues. Në të kundërtën, situatat e vazhdueshme dhe të përsëritura të përfaqësimit të pabarabartë gjinor në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen provë e praktikës së mirë.

88. Mbi këtë bazë, kuotat gjinore synojnë të përmirësojnë ekuilibrin gjinor në politikë. Ndër të tjera, ato specifikojnë përqindjet minimale të kandidateve gra për zgjedhje, zakonisht në listat e partive. Për më tepër, mund të ketë dispozita për radhën e renditjes në listë.

89. Kuotat gjinore mund të vendosen ligjërisht (*"kuota ligjore", "kuota të detyrueshme"* ose *"kuota mandatore"*), ose ato mund të miratohen vullnetarisht nga partitë politike (*"kuota vullnetare"* ose *"kuota partiake"*). Kuotat ligjore janë të detyrueshme për të gjitha partitë që paraqesin kandidatë për parlament, ndërsa kuotat e partive kanë vetëm karakter vetë-detyrues për partinë përkatëse. Të dy llojet e kuotave mund të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin zgjedhor.

90. Sipas Komisionit të Venecias dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, kuotat gjinore zgjedhore mund të konsiderohen si *"një masë e përshtatshme dhe legjitime për të rritur përfaqësimin parlamentar të grave"*. Në Deklaratën e Komitetit të Ministrave 2009 "Bërja e Barazisë Gjinore një Realitet [Making Gender Equality a Reality]", shteteve anëtare u kërkohet të lejojnë veprime pozitive ose masa të veçanta që të miratohen në mënyrë që të arrijnë përfaqësim të ekuilibruar në vendimmarrjen politike dhe publike.

91. Në mënyrë të ngjashme, në përputhje me Vendimin e OSBE-së Nr. 7/09 mbi Pjesëmarrjen e Grave në Jetën Politike dhe Publike, Këshilli Ministror u bën thirrje Shteteve pjesëmarrëse të *"marrin në konsideratë masat e mundshme legjislative, të cilat do të lehtësonin një pjesëmarrje më të ekuilibruar të grave dhe burrave jetën publike dhe posaçërisht në vendimmarrje"*, dhe *"të inkurajojë të gjithë aktorët politikë të promovojnë pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në partitë politike, me qëllim arritjen e përfaqësimit më të mirë të ekuilibrit gjinor në zyrat e zgjedhura publike në të gjitha nivelet e vendimmarrjes"*. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se të gjithë hapat e tillë konsiderohen si praktikë e mirë.

92. Këshilli i Evropës dhe OSBE-ja e pranojnë që masat legjislative janë mekanizma efektivë për promovimin e pjesëmarrjes së grave në jetën politike dhe publike. Ndërsa në anën tjetër, neni 4 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) e bën të qartë se *"miratimi nga Shtetet Palë i masave të përkohshme të posaçme që synojnë përshpejtimin e barazisë de facto midis burrave dhe grave nuk do të konsiderohet diskriminim ..."*. Si i tillë, dhe në dritën e pabarazive historike të vuajtura nga gratë në të gjithë rajonin e OSBE-së dhe globalisht, shtetet mund të nxjerrin kërkesa të veçanta ligjore ose të imponojnë masa të tjera që synojnë sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave në jetën politike dhe si kandidate.

93. Udhëzimet për rregullimin e partive politike pranojnë që *"numri i vogël i grave në politikë mbetet një çështje kritike që minon funksionimin e plotë të procesit demokratik"*. Prandaj, *"kuotat gjinore elektorale mund të konsiderohen si një masë e përshtatshme dhe legjitime për të rritur përfaqësimin parlamentar të grave"*.

94. Ekzistojnë faktorë të ndryshëm socio-ekonomikë, kulturorë dhe politikë që mund të pengojnë qasjen e grave në arenën politike. Pengesat strukturore në shoqëri që kufizojnë përfaqësimin politik të grave nuk janë të lehta për tu hequr dhe ndryshimet themelore kërkojnë shumë kohë dhe përpjekje. Kështu për shembull, ndryshimi i sistemit zgjedhor duke futur rregulla kuotash, mund të ofrojë një alternativë praktike për të rritur përfaqësimin e grave. Komisioni i Venecias, në *Kodin e tij të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore*, konsideroi se rregullat ligjore që kërkojnë një përqindje minimale të personave të secilës gjini midis kandidatëve nuk duhet të konsiderohen në kundërshtim me parimin e votimit të barabartë, nëse ato kanë një bazë kushtetuese.

95. Analiza e sistemeve zgjedhore të kuotave gjinore dhe zbatimi i tyre në Evropë tregon se një lloj kuotash gjinore elektorale për zgjedhjet publike është në përdorim në 35 vende. Trembëdhjetë vende (Shqipëria, Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Franca, Greqia, Irlanda, Mali i Zi, Polonia, Portugalia, Serbia, Sllovenia, Spanja dhe Maqedonia e Veriut) kanë inkorporuar kuota përmes ligjit që janë të detyrueshme për të gjitha partitë politike. Kuotat vullnetare të partive janë zbatuar në 22 vende, që do të thotë se të paktën një nga partitë politike të përfaqësuara në parlament ka përfshirë kuota elektorale gjinore në statutet e saj. Në gjashtë vende, asnjë kuotë gjinore nuk është në përdorim për zgjedhjet kombëtare.

96. Sidoqoftë, duhet të theksohet se sipas përvojës evropiane, megjithëse kuotat gjinore janë një mjet efektiv për rritjen e pranisë së grave në organet politike, ato nuk rezultojnë automatikisht në një përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave. Kuotat duhet të përfshijnë rregulla në lidhje me renditjen e radhitjes dhe sanksionet përkatëse për mosrespektim. [...]. "

97. Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR në disa raste kanë deklaruar se "*numri i vogël i grave në politikë mbetet një çështje kritike që minon funksionimin e plotë të proceseve demokratike"*. Në përputhje me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW), Raporti mbi Metodën e Emërimit të Kandidatëve brenda Partive Politike, kuotat zgjedhore i konsideron si masa të përkohshme të veçanta që mund të veprojnë si një *"masë e përshtatshme dhe legjitime për të rritur përfaqësimin parlamentar të grave"*. Mbetet për secilin shtet që të vendosë se si të përmirësojë barazinë gjinore. Sidoqoftë, Komisioni i Venecias konsideron që, nëse vendosen kuota ligjore, ato *"duhet të parashikojnë të paktën 30 përqind të grave në listat e partive, ndërsa 40 ose 50 janë të preferueshme"*, në mënyrë që të jenë efektive.

98. Përtej kësaj, Gjykata vëren se pjesët përkatëse të Rezolutës 1706 (2010) për rritjen e përfaqësimit të grave në politikë përmes sistemit zgjedhor të miratuar nga Asambleja Parlamentare më 27 Janar 2010, përcaktojnë si më poshtë:

> *"4 [...] Ndryshimi i sistemit zgjedhor në një sistem më të favorshëm për përfaqësimin e grave në politikë, veçanërisht me miratimin e kuotave gjinore, mund të çojë në vendimmarrje më të balancuar gjinore, dhe kështu më legjitime, politike dhe publike.*

6. Asambleja vlerëson se mungesa e përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike është një kërcënim për legjitimitetin e demokracive dhe shkelje e të drejtës themelore të njeriut për barazinë gjinore, dhe kështu rekomandon që vendet anëtare të korrigjojnë këtë situatë me përparësi nga:

6.3. reformimin e sistemit të tyre zgjedhor në një më të favorshëm për përfaqësimin e grave në parlament:

6.3.1. në vendet me sistem të listave me përfaqësim proporcional, të merret parasysh futja e një kuote ligjore e cila parashikon jo vetëm një pjesë të lartë të kandidateve gra (idealisht të paktën 40%), por edhe një rregull të rreptë të renditjes së pozitave ..., dhe sanksione efektive (mundësisht jo financiare, por më tepër mospranimi i kandidaturave/listave të kandidatëve) për mospërputhje [...];"

99. Pjesët përkatëse të *Rezolutës 2111 (2016) për vlerësimin e ndikimit e masave për të përmirësuar përfaqësimin politik të grave*, miratuar nga Asambleja Parlamentare më 21 prill 2016, përcakton si më poshtë:

"2 Kuotat zgjedhore janë mjeti më efektiv për të arritur progres të konsiderueshëm, të shpejtë, me kusht që ato të hartohen në mënyrë korrekte dhe të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme. Kuotat duhet të përshtaten me sistemin zgjedhor në fuqi, të vendosin objektiva ambicioze dhe të shoqërohen me sanksione të rrepta për mosrespektim."

100. Preambula e *Rekomandimit Rec (2003) 3 mbi pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike*, miratuar nga Komiteti i Ministrave në 12 Mars 2003, parashikon që:

"[...] pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike është çështje e gëzimit të plotë të të drejtave të njeriut, e drejtësisë sociale dhe një kusht i domosdoshëm për funksionimin më të mirë të një shoqërie demokratike."

Zbatimi i Parimeve të lartcekura në rastin konkret

101. Gjykata fillimisht rikujton që parashtrueset e kërkesës, në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, në cilësi të kandidateve për deputete nga radhët e subjektit politik LVV kishin arritur rezultatin vijues zgjedhor:

parashtruesja e parë, znj. Tinka Kurti - 7655 vota; dhe, parashtruesja e dytë, znj. Drita Millaku - 7063 vota. Ndërkaq, në anën tjetër, kandidati Eman Rrahmani kishte arritur një rezultat zgjedhor sipas të cilit ai kishte fituar 611 vota më pak se parashtruesja e parë dhe 19 vota më pak se parashtruesja e dytë.

102. Mbi këtë bazë, Gjykata vëren se me rastin e formimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, deputetët e subjektit politik LVV, të cilët u zgjodhën në pozita qeveritare, liruan 5 pozita të deputetëve. Andaj, kandidati Enver Haliti me 7,777 vota zëvendësoi deputetin Albin Kurti; kandidati Alban Hyseni me 7,767 vota zëvendësoi deputetin Glauk Konjufca; kandidatja Arta Bajralia me 7,674 vota zëvendësoi deputeten Albulena Haxhiu; kandidati Fitim Haziri me 7,542 vota zëvendësoi deputetin Arben Vitia; kandidati Eman Rrahmani me 7,044 vota zëvendësoi deputetin Haki Abazi. Më vonë, kandidati Taulant Kryeziu me 6968 vota zëvendësoi deputetin Shpejtim Bulliqi.

103. Faktet e lartcekura dhe vendimet e kontestuara dëshmojnë se të gjitha zëvendësimet në legjislaturën e kaluar të Kuvendit janë bërë mbi bazën e zëvendësimit brenda po të njëjtës gjini (burrë-burrë dhe grua-grua), duke u thirrur në aplikim direkt të nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Këto zëvendësime ishin bërë pa marrë për bazë rezultatin zgjedhor që kishin shënuar kandidatët për deputetë pas përmbushjes së kuotës ligjore prej 30% të përcaktuar me nenin 27 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

104. Në këtë aspekt, ashtu siç u definua më lart, Gjykata rithekson se aspekti kryesor i kësaj ankese kushtetuese ka të bëjë me faktin se: *A është zbatuar neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nga ana e KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme, në përputhje me garancitë, vlerat dhe parimet e përcaktuara në nenet 24 dhe 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së?*

105. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që zëvendësimet e lartcekura të deputetëve paraprak me deputetë të rinj kanë qenë të domosdoshme të bëhen pasiqë në total 6 deputetë të LVV-së ishin emëruar në funksione qeveritare ose komunale. Kjo domosdoshmëri e zëvendësimit të deputetëve ka aktivizuar në mënyrë automatike dispozitat ligjore të përcaktuara me nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

106. Ky nen i veçantë – e që është nen kyç në këtë rast - specifikon mënyrën e zëvendësimit të deputetëve. Konkretisht, neni në fjalë lexon me sa vijon:

"112.2 Një anëtar i Kuvendit të Kosovës mandati i të cilit përfundon në pajtim me nenin 112.1 zëvendësohet si vijon:

a) nga kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini i cili ka fituar numrin më të madh të votave të listës së riorganizuar të kandidatëve të Subjektit Politik në emër të së cilës garoi anëtari; [...]."

107. Pas ankesave të paraqitura nga dy parashtrueset e kërkesës se atyre në mënyrë të padrejtë dhe në mënyrë diskriminuese po u mohohej e drejta për tu zgjedhur, KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme iu është dashur që ta interpretojnë këtë nen specifik dhe ta aplikojnë atë në rrethanat e rastit konkret. Parashtrueset e kërkesës në thelb kishin pretenduar se përkundër plotësimit dhe tejkalimit të kuotës prej 30% nga kandidatet gra për deputete nga LVV – zëvendësimet për deputetë ishin bërë jo bazuar në rezultatin zgjedhor por bazuar në gjini. Sipas tyre, kjo gjë ka shkaktuar pabarazi në trajtim dhe shkelje të së drejtës së tyre për tu zgjedhur.

108. KQZ e kishte zbatuar këtë nen ashtu që të gjitha zëvendësimet e deputetëve ishin rekomanduar të bëhen me kandidatin në radhë të së njëjtës gjini, pavarësisht faktit se a është plotësuar kuota prej 30% e gjinisë së nënpërfaqësuar apo jo. Kësisoj, KQZ kishte rekomanduar që kandidati Eman Rrahmani me 7.044 vota të bëhet deputet – duke tejkaluar nga radha për zëvendësim kandidaten e gjinisë femërore, Tinka Kurti me 7.655 vota dhe kandidaten tjetër të gjinisë femërore Drita Millaku, me 7.063 vota. Të dy kandidatet gra në fjalë – parashtruese të kërkesës para kësaj Gjykate – kishin vota më shumë se sa kandidati burrë, Eman Rrahmani. Mirëpo, bazuar në interpretimin që KQZ i kishte bërë nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, zëvendësimet ishin bërë vetëm dhe ekskluzivisht brenda gjinisë së njëjtë.

109. Më tutje, PZAP kishte konfirmuar mënyrën se si KQZ e kishte interpretuar nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në rrethanat e parashtrueseve të kërkesës. PZAP kishte sqaruar se në zbatim të po atij neni, zëvendësimi është bërë në atë mënyrë që deputetët burra janë zëvendësuar me kandidatët e radhës burra, ndërsa deputetet gra janë zëvendësuar me kandidatet e radhës gra. Rrjedhimisht, sipas PZAP-it, Vendimi i KQZ-së ishte "*i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi që zëvendësimet për anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës bëhen duke marrë parasysh kandidatin e radhës të njëjtës gjini dhe të njëjtit subjekt politik, ashtu si është vepruar edhe në rastin konkret*".

110. Këtë logjikë interpretimi dhe këtë arsyeshmëri zbatimi e kishte përkrahur edhe Gjykata Supreme kur i kishte konfirmuar në tërësi si të ligjshme vendimmarrjet në nivel të PZAP-it dhe KQZ-së. Sipas Gjykatës Supreme, neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ka paraparë mënyrën e zëvendësimit të deputetëve ashtu që zëvendësimi të bëhet me deputetë të rinj nga i njëjti subjekt politik dhe sipas gjinisë së njëjte. Kësaj mënyre të zëvendësimit të paraparë me ligj, sipas Gjykatës Supreme, nuk kanë mundur t'i shmangen as KQZ, as PZAP e as Gjykata Supreme ngase ekziston supozimi se ligjet janë në pajtim me Kushtetutën dhe se ato duhet zbatuar ashtu siç janë *"deri sa nga Gjykata Kushtetuese të konstatohet se një ligj ose ndonjë dispozitë ligjore e tij është në kundërshtim me Kushtetutën"*. Andaj, sipas Gjykatës Supreme, zgjidhja ligjore e paraparë me nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk mund të thuhet se është kundërkushtetuese.

111. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nuk është e pajtimit se interpretimi i këtij neni nga ana e KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme është interpretim i saktë edhe kushtetues, dhe atë për arsyet që do të ceken gjerësisht në arsyetimin vijues të këtij Aktgjykimi.

112. Si çështje paraprake duhet të sqarohet fakti se Gjykata nuk është duke vlerësuar *in abstracto* nëse neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është apo nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën. Kjo për faktin që, as para kësaj Gjykate e as para institucioneve paraprake publike që e kanë trajtuar këtë çështje, parashtrueset e kërkesës asnjëherë nuk kanë pretenduar që neni në fjalë është kundërkushtetues. Përkundrazi, ato vetëm kanë pretenduar që ky nen është zbatuar në mënyrë kundërkushtetuese nga KQZ, PZAP e Gjykata Supreme.

Si rrjedhojë, vlerësimi i Gjykatës në këtë rast është vlerësim konkret i cili kufizohet në shqyrtimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme dhe faktit se a janë këto vendime në pajtueshmëri me nenet 24 dhe 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

113. Thënë këtë, Gjykata është e mendimit se edhe KQZ, por edhe PZAP e Gjykata Supreme, e kanë interpretuar nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në mënyrë të ngurtë e tekstuale dhe të shkëputur nga të gjitha normat e tjera ligjore të parapara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Barazi Gjinore si dhe parimet, vlerat dhe frymën e shkronjës e Kushtetutës. Ky lloj interpretimi ka abstrahuar kontekstin, qëllimin dhe arsyen e vendosjes së kuotës prej

30%, si masë e veçantë për të ndihmuar drejt arritjes së përfaqësimit të barabartë në mes të dy gjinive në Kuvendin e Republikës.

114. Sipas një interpretimi të tillë të normës ligjore, zëvendësimi i deputetëve të LVV, asokohe, ishte bërë nga kandidatët e radhës për deputetë të LVV-së nga *"e njëjta gjini"*, ashtu që deputetët burra ishin zëvendësuar me deputetë burra – pa marrë në konsideratë efektin e rezultatit zgjedhor që kishin arritur gratë kandidate për deputete pas përmbushjes së kuotës së përfaqësimit prej 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar (në rastin konkret gjinisë femërore).

115. Interpretimi tekstual i konceptit kyç të këtij rasti që zëvendësimi të bëhet ekskluzivisht dhe vetëm nga e njëjta gjini, pa marrë parasysh rrethanat relevante faktike në aspekt të aplikimit të kuotave gjinore dhe qëllimit të tyre, ka dërguar në një vendimmarrje ku KQZ ka shmangur zbatimin e rezultatit të votimeve të kandidatëve për deputetë në favor të zbatimit *in blanco* të nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që parasheh se zëvendësimi bëhet nga "*kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini"*. Ky interpretim i KQZ-së, i miratuar më pas edhe me vendimmarrjen e PZAP-it dhe Gjykatës Supreme, në praktikë ka rezultuar me fitimin e mandateve nga kandidatët burra, pavarësisht faktit që kandidatet gra (parashtrueset e kërkesës) kishin fituar më shumë vota në një situatë **pas plotësimit të kuotës ligjore prej 30%** për përfaqësim të gjinisë pakicë.

116. Arsyetimi i Gjykatës Supreme rreth përcaktimit ligjor të paraparë me nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme nuk mund t'i shmanget as KQZ, as PZAP e as Gjykata Supreme *"deri sa nga Gjykata Kushtetuese të konstatohet se një ligj ose ndonjë dispozitë ligjore e tij është në kundërshtim me Kushtetutën"* - kërkon përgjigje të veçantë për të paktën dy arsyet vijuese.

117. E para ka të bëjë me faktin që kjo Gjykatë e konsideron jashtëzakonisht të rëndësishme të potencojë kompetencën dhe detyrimin kushtetues të gjykatave të rregullta dhe të të gjitha autoriteteve publike që të vendosin rastet para tyre jo vetëm bazuar në ligj por edhe bazuar në Kushtetutë. Më specifikisht, Gjykata tashmë ka theksuar se bazuar në nenet 102.3 dhe 112.1 të Kushtetutës, të gjitha gjykatat e rregullta, *"duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme si instancë më të lartë gjyqësore në nivel të Republikës, kanë për obligim të interpretojnë ligjet në harmoni me Kushtetutën."* Tutje, Gjykata ka potencuar se: *"Kushtetuta, autorizimin për të interpretuar Kushtetutën si dhe autorizimin për të interpretuar ligjet në pajtim me Kushtetutën ua njeh të gjitha gjykatave dhe autoriteteve të tjera publike në Republikën e Kosovës. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese është*

autoriteti i vetëm në Republikën e Kosovës me autorizim ekskluziv kushtetues për të shfuqizuar një ligj ose normë ligjore si dhe për të bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me të" (shih, më tepër, lidhur me kompetencat dhe obligimet e gjykatave të rregullta rreth aplikimit të normave kushtetuese, rastin e Gjykatës KI207/19, cituar më lart, paragrafët 112-130).

118. E dyta ka të bëjë me faktin se në këtë rast konkret nuk ishte asnjëherë objekt shqyrtimi kushtetutshmëria e nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme. Në këtë rast, çështja përkon me mënyrën e interpretimit të kësaj norme ligjore në ndërlidhje me parimet e përgjithshme kushtetuese si dhe në ndërlidhje me normat e tjera relevante ligjore nga Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji për Barazi Gjinore që është dashur të merren parasysh për të përcaktuar në mënyrë të saktë se cila është mënyra e saktë e zëvendësimit të deputetëve në një fazë pas-plotësimit të kuotës ligjore prej 30%. Në rrethana të tilla, detyrë e KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme ka qenë që të merren parasysh të gjitha normat ligjore e kushtetuese që kanë të bëjë me kuotat dhe qëllimin e tyre dhe jo të bëhet interpretimi bazuar në një nen të vetëm.

119. Interpretimi i nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme sipas mënyrës së interpretimit nga KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme do të kishte kuptim vetëm në situatën kur mund të ndodhë që moszëvendësimet gjini-për-gjini (grua-për-grua ose burrë-për-burrë) do të mund të rrezikonin mospërmbushjen e kuotës ligjore prej 30% të përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar. Mirëpo, interpretimi i këtij neni, në mënyrën siç është bërë, kur dihet se në zgjedhjet e 6 tetorit 2019 kandidatet gra të subjektit politik LVV kishin arritur të merrnin vota meritore përtej përqindjes së kuotës ligjore prej 30%, është interpretim i gabuar i kësaj norme dhe në shpërputhje me vet qëllimin e kuotave ligjore të përcaktuara me nenin 27 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

120. Gjykata ka parasysh që interpretimi i kësaj norme ligjore në mënyrën siç theksohet në këtë Aktgjykim mund të paraqesë situata kur në fazën e pas-plotësimit të kuotës gjinore prej 30%, deputetët e gjinisë pakicë do të mund të zëvendësohen me deputetë të gjinisë shumicë, bazuar në rezultatet e zgjedhjeve. Për shembull, mund të ndodhë që një grua që merr post qeveritar do të zëvendësohet me një burrë që për nga votat e fituara pas plotësimit të kuotës prej 30% është në radhë si kandidat për tu bërë deputet. Por mund të ndodhë edhe e kundërta, që një burrë që merr post qeveritar do të zëvendësohet me një grua që për nga votat e fituara pas plotësimit të kuotës prej 30% është në radhë si

kandidate për tu bërë deputete, siç do duhej të kishte ndodhur me rastet e parashtrueseve të kërkesës të këtij rasti. E vetmja situatë që kurrsesi nuk mund të ndodhë bazuar në legjislacionin në fuqi dhe interpretimin përfundimtar të dhënë me këtë Aktgjykim është rrezikimi i përfaqësimit në kuotën prej 30%.

121. Qëllimi i vendosjes së kuotave, siç do të tregojë edhe analiza e mëtejme, ndërlidhet me nevojën për avancimin e barazisë gjinore brenda një shoqërie deri në arritjen e një barazie faktike kur kuotat bëhen të panevojshme. Neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ekziston për një arsye të vetme: të paraqesë mënyrën e zëvendësimit të deputetëve – gjithnjë duke ruajtur qëllimin e përfaqësimit detyrues ligjor prej të paktën 30% të gjinisë pakicë. Nëse pas plotësimit të normës prej 30%, kandidatët nga gjinia pakicë arrijnë të bëhen deputetë me forcat e tyre vetanake duke korrur rezultat më të mirë se sa pjesëtarët e gjinisë shumicë, atyre nuk duhet tu mohohet e drejta për tu zgjedhur deputetë të Kuvendit.

122. Në raport me kërkesat që rrjedhin nga neni 24 i Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNJ-së si dhe neni 45 i Kushtetutës dhe neni 3 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata thekson se çështja paraprake që duhet të definohet është se a ka pasur dallim në trajtim në mes të parashtrueseve të kërkesës dhe deputetëve të Kuvendit të cilët u zgjodhën nga lista e kandidatëve zëvendësues për kandidatët për deputetë.

123. Përderisa në rastin konkret dallimi në trajtim bazohet në gjininë e kandidatëve, koncepti i justifikimit të arsyeshëm dhe objektiv duhet të interpretohet në mënyrë strikte. Duke e thënë këtë, vlen të përmendet po ashtu që 24 i Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNJ-së nuk ndalojnë trajtimin e ndryshëm të grupeve në mënyrë që të korrigjojë *"pabarazitë faktike"* ndërmjet tyre. Në fakt në raste të caktuara dështimi për të korrigjuar pabarazitë përmes trajtimit të ndryshëm, mundet që pa një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv të përcaktojë shkelje të atij neni (shih rastet e GJEDNJ-së: *Çështja "në lidhje me aspekte të caktuara të ligjeve për përdorimin e gjuhëve në arsim në Belgjikë" kundër Belgjikës*, cituar më lartë, paragrafi 10; *Thlimmenos kundër Greqisë*, Aktgjykim i 6 prillit 2000, paragrafi 44; dhe *D.H. dhe të tjerët kundër Çekisë*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 175; *Sejdić and Finci kundër Bosnjes dhe Hercegovinës*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2009, paragrafi 44).

124. Për tu kthyer tek rasti i tanishëm, duke nënvizuar rezultatet e lartcekura të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvend, Gjykata thekson që është evidente që në kuadër të subjektit politik LVV, bazuar në

rezultatin zgjedhor të zgjedhjeve të përgjithshme të 6 tetorit 2019, rezulton që të njëjtit si subjekt politik kishin fituar 29 vende të deputetëve. Gjithashtu, Gjykata nënvizon që të gjithë deputetët ishin zgjedhur në bazë të rezultatit zgjedhor, ku nga 29 deputetë, 10 deputete ishin gra, ndërsa 19 ishin deputetë burra. Pra, ky rezultat konsiston në përfundimin që kandidatet gra në kuadër të subjektit politik LVV, fituan mbi 34% të vendeve të subjektit politik LVV. Rrjedhimisht, dallimi në trajtim në mes të parashtrueseve të kërkesës dhe deputetëve të Kuvendit të cilët u zgjodhën nga lista e kandidatëve zëvendësues për kandidatët për deputetë, lidhur me zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit, ishte *përcaktuar me ligj,* përkatësisht përmes nenit 112.2 (a) (Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendit) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

125. Gjykata në vijim do të vlerësojë nëse Vendimi i kontestuar përmbush kushtet e të ndjekurit një *qëllim legjitim* dhe është në përputhje me *parimin e proporcionalitetit*.

126. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se në bazë të vlerësimit të KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme, në mënyrë që kandidati të jetë i pranueshëm për të bërë zëvendësimin e deputetëve, si kriter parësor u vlerësua të jetë gjinia e kandidatit, ndërsa kriteri i dytë ishte rezultati zgjedhor për kandidatë të listës së kandidatëve të subjektit politik LVV. Pra, rezultati zgjedhor që kanë arritur kandidatët për deputetë në bazë të vlerësimit të parë afirmohet (pasi që primare është të zëvendësohen deputetët me kandidatët për deputetë të të njëjtës gjini), ndërsa rezultati zgjedhor hyn në punë vetëm në kuadër të përcaktimit të renditjes së kandidatëve brenda gjinisë së njëjtë.

127. Mbi këtë bazë, Gjykata vëren se koncepti i kuotës gjinore, si dhe avancimi i barazisë gjinore mbetet një qëllim kryesor në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Gjithashtu, institucionet e kësaj organizate konsiderojnë që mungesa e barazisë gjinore në politikëbërje, përbën kërcënim të legjitimitetit demokratik si dhe shkelje të barazisë gjinore (shih paragrafët 86-100 të këtij Aktgjykimi ku reflektohen këto parime më gjerësisht). Një qasje të ngjashme përmban edhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përmban detyrimin për përfaqësim të gjinisë së nënpërfaqësuar në kuotën gjinore prej 30% (shih neni 27 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme).

128. Gjykata vëren se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përmban detyrimin e kuotës gjinore si formë e përfaqësimit në Kuvend, në masën *minimum 30 % për gjininë e nënpërfaqësuar*. Pra, ndarja e ulëseve funksionon në atë mënyrë që pas ndarjes së vendeve për subjektet politike, nëse kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë

së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë, zëvendësohet nga një kandidat i radhës i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30% (shih nenin 111.6 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, bazuar në plotësim ndryshimet e bëra me Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e LZP-së – nene këto të cituara në pjesën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore).

129. Në kontekst të kuotës gjinore të përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Gjykata gjithashtu rikujton paragrafin 3 të nenit 24 të Kushtetutës i cili përcakton se:

> *Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

130. Rrjedhimisht ngjashëm me nenin 24 të Kushtetutës, edhe neni 14 i KEDNJ-së, nuk i ndalon shtetet anëtare nga trajtimi ndryshe i grupeve, në mënyrë që të korrigjojë *"pabarazitë faktike"* ndërmjet tyre. Për më tepër, në rrethana të caktuara një dështim në përpjekjen për të korrigjuar pabarazinë përmes një trajtimi të ndryshëm, mundet pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të shkaktojë shkelje të këtyre neneve (shih rastet e GJEDNJ-së: *Çështja "në lidhje me aspekte të caktuara të ligjeve për përdorimin e gjuhëve në arsim në Belgjikë" kundër Belgjikës*, cituar më lartë, paragrafi 10; *Thlimmenos kundër Greqisë*, cituar më lartë, paragrafi 44; dhe *D.H. dhe të tjerët kundër Çekisë*, cituar më lartë, paragrafi 175; *Sejdić and Finci kundër Bosnjes dhe Hercegovinës*, cituar më lartë, paragrafi 44).

131. Gjykata vlerëson se kuptimi i barazisë i synuar në rastin konkret e ka edhe dimensionin tjetër, përkatësisht diskriminimin pozitiv apo përcaktimin e kuotës gjinore për përfaqësim të grave në cilësi të gjinisë së nënpërfaqësuar, e cila konsiderohet të jetë në pajtueshmëri me frymën e idealeve kushtetuese dhe identitetit kushtetues të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, parimet kushtetuese të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit mbeten të një rëndësie vendimtare dhe se çështja e kuotave gjinore, për arsye historike dhe kulturore, si dhe të mënjanimit të *pabarazive faktike* në mes grave dhe burrave, është në pajtueshmëri me frymën e sistemit normativ kushtetues. Përfundimisht, koncepti i barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit është dinamik dhe evoluon në drejtim të plotësimit të idealit sublim të

barazisë në përfaqësim të grave dhe burrave në relacionin 50% me 50%.

132. Prandaj, Gjykata vëren se qëllimi i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në kontekst të përfaqësimit gjinor në kuadër të Kuvendit, konsiston në atë që siguron përfaqësim të gjinisë së nënpërfaqësuar (gjinisë pakicë), i cili nuk mund të jetë nën 30%. Mirëpo, qartazi, 30% paraqet kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar.

133. Në të njëjtën frymë konsiston të jetë edhe neni 112 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili shërben për të treguar mënyrën e zëvendësimit të deputetëve, me ç'rast zëvendësohen kandidatët nga gjinia e njëjtë si mënyrë për të ruajtur pragun minimal të përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar në kuotën prej 30%. Mirëpo, në rastin e parashtrueseve të kërkesës ka rastisur që me rastin e zëvendësimit të deputetëve si rezultat i rrethanave të lartcekura (të zgjedhurit e deputetëve në poste qeveritare), në momentin kur janë zëvendësuar me kandidatët e të njëjtës gjini, ka rezultuar që deputetët Fitim Haziri dhe Eman Rrahmani të kishin më pak vota se parashtruesja e kërkesës Tinka Kurti ndërsa në rastin e parashtrueses së kërkesës Drita Millaku, vetëm kandidati Eman Rrahmani kishte më pak vota.

134. Gjykata konsideron, që kjo masë e përcaktuar në Ligjin e Zgjedhjeve të Përgjithshme, përkatësisht përcaktimi i përfaqësimit minimal të gjinisë pakicë në minimum 30%, si e tillë është e domosdoshme në mënyrë që të mundësojë përfaqësimin edhe të gjinisë së nënpërfaqësuar në Kuvend, respektivisht grave. Si i tillë, ky përcaktim i ligjit për kuota gjinore, në parim nuk paraqet shkelje të të drejtave zgjedhore. Mirëpo, në rrethanat e rastit konkret, përderisa kuota minimale e përfaqësimit në kuadër të subjektit politik LVV është arritur në tërësi në bazë të rezultatit zgjedhor të zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, nuk është paraqitur nevoja që të zbatohet kuota gjinore prej 30%. Rrjedhimisht kandidatet gra në kuadër të subjektit politik LVV kishin fituar 10 nga 29 vende, apo mbi 34% të vendeve në kuadër të numrit të përgjithshëm 29. Prandaj, si rrjedhojë e rezultatit zgjedhor, përdorimi i kuotës gjinore është konsumuar, pasiqë qëllimi legjitim për të cilin ekziston veçse është përmbushur dhe tejkaluar përmes rezultatit zgjedhor.

135. Rrjedhimisht, në momentin e zëvendësimit të kandidatëve për deputetë, me ç'rast si deputetë u zgjodhën Fitim Haziri dhe Eman Rrahmani, në bazë të zëvendësimit të të njëjtës gjini, ka rezultuar që është cenuar *esenca e rezultatit zgjedhor* për parashtruesen e kërkesës Tinka Kurti, ndërsa për parashtruesen e kërkesës Drita Millaku,

esenca e rezultatit zgjedhor është cenuar vetëm në raport me kandidatin Eman Rrahmani. Pra, masa e tillë (kuota gjinore 30 %) e vendosur për mënjanimin e pabarazive faktike në mes të grave dhe burrave, në rastin konkret ka vijuar të zbatohet, përkundër asaj që qëllimi për të cilin është vendosur veçse është arritur përmes rezultatit zgjedhor nga kandidatet gra në kuadër të LVV-së.

136. Kjo për faktin se në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nënpërfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e ardhshme duhet të bëhen në bazë të renditjes së kandidatëve për deputetë, të cilën e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%.

137. Në momentin kur kjo kuotë gjinore minimale arrihet apo tejkalohet përmes rezultatit zgjedhor të kandidatëve për deputetë, qëllimi që synohet të arrihet përmes normës mbetet pa efekt. Nëse do të ishte ndryshe, kuota gjinore prej 30% do të nënkuptonte se qëndron për të siguruar një gjendje të *status-quo*, pasiqë e njëjta nuk afirmon përfaqësimin përtej kuotës 30% për gjininë e nënpërfaqësuar, në rastet kur bëhet zëvendësimi i deputetëve të Kuvendit. Një interpretim i tillë i izoluar dhe i ngurtë i normës ligjore që rregullon mënyrën e zëvendësimit të deputetëve është në kundërshtim me vet *ratio legis* të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që synon të avancojë përfaqësimin e grave në Kuvend, si gjini e nënpërfaqësuar apo gjini pakicë në rrethanat e tanishme politike dhe historike.

138. Pra, mbi këto premisa, dhe përderisa përfaqësimi minimal prej 30% është arritur, përkatësisht tejkaluar në bazë të rezultatit zgjedhor, të zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, do duhej të konsistonte kjo radhitje e kandidatëve për deputetë të cilët zëvendësojnë deputetët, si në vijim: parashtruesja e kërkesës (1) Tinka Kurti ka 7,655 vota, pas saj vjen (2) Fitim Haziri me 7,542 vota, më pas vjen parashtruesja e kërkesës (3) Drita Millaku me 7,063 vota dhe (4) Eman Rrahmani me 7,044 vota.

139. Prandaj, Gjykata konsideron që në rastin konkret parashtruesja e kërkesës Tinka Kurti është diskriminuar në bazë të gjinisë, në momentin kur edhe përkundër përmbushjes së kuotës minimale 30% përmes rezultatit zgjedhor në kuadër të subjektit politik LVV, në momentin kur u krijua mundësia e zëvendësimit të deputetëve, e njëjta edhe pse kishte më shumë vota se kandidatët për deputetë Fitim Haziri dhe Eman Rrahmani, nuk iu mundësua që të zgjidhej deputete. Prandaj, Gjykata konstaton se ndaj parashtrueses së kërkesës Tinka Kurti, përmes Aktvendimin [AA .nr. 4/2020] të 19 shkurtit 2020, të

Gjykatës Supreme ka pasur shkelje të neneve 24 dhe 45 të Kushtetutës në lidhje me nenit 14 dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

140. Sa i përket parashtrueses së kërkesës Drita Millaku bazuar në rrethanat e njëjta të lartpërmendura, ajo është diskriminuar në bazë të gjinisë në lidhje me të drejtën e saj për t'u zgjedhur, në momentin kur edhe përkundër përmbushjes së kuotës minimale 30% nëpërmjet rezultatit zgjedhor në kuadër të subjektit politik LVV, në momentin kur u krijua mundësia për zëvendësimet e ardhshme të deputeteve, përkatësisht kur dha dorëheqje deputeti Shpejtim Bulliqi, në vend të tij, në bazë të përcaktimit për zëvendësim në kuadër të gjinisë së njëjtë, më 18 dhjetor 2020, mandat deputeti mori kandidati Taulant Kryeziu me 6968 vota.

141. Prandaj, Gjykata konstaton se ndaj parashtrueses së kërkesës Drita Millaku përmes Aktvendimit [AA .nr. 3/2020] të 19 shkurtit 2020, të Gjykatës Supreme ka pasur shkelje të neneve 24 dhe 45 të Kushtetutës në lidhje me nenit 14 dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

142. Gjykata gjithashtu sqaron faktin se ndonëse neni 6.8 i Ligjit për Barazi Gjinore parasheh që: "*Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrës;*". Kuvendi si ligjvënës nuk e ka formuluar këtë përqindje si një kuotë obligative ligjore por, e ka formuluar më tepër në formë të një ideali kushtetues, ligjor e faktik që shoqëria demokratike e Republikës së Kosovës duhet ta arrijë dhe se vetëm pas arritjes së saj sigurohet barazia e vërtetë faktike. Pra, 50%-shi i normuar në nenin 6.8 të Ligjit për Barazi Gjinore nuk është një kuotë ligjore për përfaqësim të detyrueshëm siç është 30%-shi i normuar në nenin 27 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ku specifikisht paraqitet obligimi që: "*Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) përqind janë femra [...]*".

143. Ndonëse ideali kushtetues dhe fryma e Kushtetutës e reflektuar në nenin 7 synojnë arritjen e barazisë faktike 50% me 50% në mes të dy gjinive, Gjykata Kushtetuese është e vetëdijshme që nuk është në kompetencën e saj që të caktojë politika të reja publike e as të vlerësojë nëse një politikë publike e deritashme është e mirë apo e duhur. Gjithashtu, nuk i takon Gjykatës që të ri-vendosë kuota të reja ligjore ose të rrisë përqindjen e kuotave ligjore të përfaqësimit gjinor në favor të asnjërës gjini. Ligjvënësit e Republikës së Kosovës janë ata që kanë vendosur kuotën prej 30% si kuotë të vetme ligjore të aplikueshme, e

cila duhet ruhet në çdo rrethanë përderisa autoritetet kompetente nuk vendosim që të bëjnë ndryshime ligjore në këtë aspekt, nëse ato e shohin të nevojshme. Janë gjithashtu ligjvënësit ata që kanë caktuar 50%-shin si ideal kushtetues të përfaqësimit të barabartë gjinor duke theksuar se përfaqësimi i barabartë gjinor arrihet vetëm kur sigurohet përfaqësim 50-50 për secilën gjini.

144. Megjithatë, të gjitha këto diskutime të rëndësishme hyjnë në domenin e çështjeve të politikbërjes publike, domen ky që i takon Qeverisë dhe Kuvendit se si ata konsiderojnë që është mënyra më e mirë për të arritur idealin e përfaqësimit 50-50. Për shembull, Komisioni i Venecias thekson se nëse shtetet vendosin që të miratojnë kuota ligjore, atëherë ato *"duhet të parashikojnë të paktën 30 përqind të grave në listat e partive, ndërsa 40 ose 50 janë të preferueshme"*, në mënyrë që kuotat të jenë efektive.

145. Gjykata e sheh gjithashtu të nevojshme të theksojë obligimin e KQZ-së, si organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me proceset zgjedhore, që edhe në procesin e zgjedhjes së deputetëve dhe zëvendësimit të tyre të marrë parasysh faktin që në kuadër të secilit subjekt politik, në momentin kur përmes rezultatit zgjedhor arrihet ose tejkalohet përmbushja e kuotës gjinore në masën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar, (siç ishte në rastin konkret ku kandidatet për deputete gra kanë fituar më shumë se 34% të vendeve), atëherë kurdo që shtrohet nevoja e zëvendësimit të kandidatëve për deputetë të Kuvendit, vlen rezultati zgjedhor, nëse i njëjti nuk e vë në pikëpyetje përfaqësimin minimal 30%. Pra, në momentin kur përmbushet përfaqësimi minimal në masën 30% në bazë të rezultatit zgjedhor, atëherë zëvendësimet e deputetëve bëhen nga kandidatët për deputetë të cilët janë ranguar më lartë nëpërmjet rezultatit zgjedhor, përderisa ruhet apo nuk cenohet minimumi i përfaqësimit prej 30%.

146. Përfundimisht, bazuar në analizën e mësipërme, Gjykata konkludon që: Aktvendimi [AA .nr. 4/2020] i 19 shkurtit 2020, i Gjykatës Supreme; Aktvendimin [AA. nr. 3/2020] e 19 shkurtit 2020, i Gjykatës Supreme; Vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), [Anr. 35/2020], i 13 shkurtit 2020; Vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa , [Anr. 36/2020], i 13 shkurtit 2020; si dhe pika 5 e Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), [Nr. 102/A-2020], të 7 shkurtit 2020, janë në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Efektet e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese

147. Siç u tha më lart, të dy vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme, por edhe vendimet e PZAP-it dhe të KQZ-së, nuk janë në pajtueshmëri me nenet 24 dhe 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

148. Për nga aspekti praktik i zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit rithekson faktin se në të gjitha rastet kur konstatohet shkelje e të drejtave dhe lirive të njeriut e cila nuk mund të riparohet tërësisht e as të kthehet në pikën zero kur shkelja nuk ka ekzistuar, shtrohet pyetja e efektit të Aktgjykimit që konstaton shkeljen në fjalë.

149. Gjykata rikujton që në praktikën e saj gjyqësore, pyetje të ngjashme rreth efektit të vendimit janë shtruar në disa raste të ndryshme, përfshi edhe në raste të çështjeve zgjedhore (shih në këtë aspekt, rastin e Gjykatës KI207/19, me parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, Aktgjykim i 5 janarit 2021, paragrafi 240; shih gjithashtu Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI193/18, me parashtrues *Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020, paragrafët 149-151 ku, në mes referencave të tjera, citohet edhe rasti i GJEDNJ-së, *Kingsley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 28 majit 2002, paragrafi 40; KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, Aktgjykim i 8 tetorit 2019, paragrafët 116-120; KI108/18, parashtrues *Blerta Morina*, Aktvendim për papranueshmëri i 1 tetorit 2019, paragrafi 196).

150. Gjykata vëren se, për arsye objektive dhe në interes të sigurisë juridike, ky Aktgjykim nuk mund të prodhojë efekt juridik prapaveprues në lidhje me mandatet e deputetëve. Në këtë aspekt, Gjykata sqaron që në bazë të parimit të sigurisë juridike, ky Aktgjykim nuk ka efekt prapaveprues dhe nuk prek të drejtat e palëve të treta të fituara në bazë të vendimeve të anuluara me këtë Aktgjykim. Megjithatë, ky Aktgjykim nuk është thjesht deklarativ dhe pa efekte.

151. Gjykata ripërsëritë edhe kësaj here faktin se ndonëse ajo nuk ka autorizime ligjore për të caktuar ndonjë kompensim të dëmit për rastet kur konstaton shkelje të dispozitave respektive kushtetuese, një aspekt i tillë nuk nënkupton që parashtrueset e kërkesës nuk kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre bazuara në Kushtetutë dhe ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

152. Efekti i parë i këtij Aktgjykimi është shfuqizimi i vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme, PZAP-it dhe KQZ-së, si të papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në në aspekt të interpretimit të nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Përmes shfuqizimit të këtyre vendimeve paraprake, ky Aktgjykim sqaron për të ardhmen se, bazuar në një lexim të saktë dhe kontekstual të nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, zëvendësimi i kandidatëve për deputetë duhet të bëhet në atë mënyrë që: *së pari*, sigurohet përfaqësimi minimal në masën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar (gjinisë pakicë), e cila nuk mund të vihet në pikëpyetje në asnjë moment; dhe *së dyti*, në rastet kur kuota gjinore prej 30 % është përmbushur bazuar në rezultatin zgjedhor (siç ishte rasti konkret), atëherë zëvendësimet e kandidatëve për deputetë, duhet të bëhen në bazë të rezultatit zgjedhor, pa u kufizuar në aspektin e zëvendësimit në bazë të gjinisë së njëjtë, përderisa nuk rrezikohet minimumi i përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar.

153. Efekti i dytë që ky Aktgjykim mundëson ka të bëjë me të drejtën që iu lind parashtrueseve të kërkesës ose palëve të tjera që mund të preken nga ky Aktgjykim, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij të fundit. Këtyre palëve iu lind e drejta për shfrytëzimin e mjeteve të tjera juridike në dispozicion për realizimin e mëtejmë të të drejtave në përputhje me gjetjet e këtij Aktgjykimi. Kjo e drejtë lidhur me parashtrueset e kërkesës lind nga momenti kur ato do duhej të bëheshin deputete, nëse neni 112.1.a i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme do të interpretohej në përputhje me arsyetimin e këtij Aktgjykimi (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Paunović dhe Milivojević kundër Serbisë*, të 24 majit 2016, kërkesa nr. 41683/06 - rast ku GJEDNJ kishte gjetur shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së për arsye se *"përfundimi i mandatit të parashtruesit* [deputet i zgjedhur i Kuvendit] *ishte bërë në shkelje të Ligjit për Zgjedhjen e Deputetëve të Kuvendit",* paragrafët 61-66 dhe paragrafi 80).

Përfundime

154. Rastet e bashkuara KI45/20 dhe KI46/20 janë dy raste që kanë të bëjnë me kontestet rreth zgjedhjeve të 6 tetorit 2019. Kërkesat janë parashtruar nga dy kandidate (Tinka Kurti dhe Drita Millaku) për deputete nga subjekti politik i Lëvizjes VETËVENDOSJE! (LVV) – të cilat pretendonin se KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme kanë zbatuar në mënyrë kundërkushtetuese mënyrën e zëvendësimit të deputetëve të përcaktuar me nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

155. Gjykata rikujton që disa deputetë të subjektit politik LVV, të cilët u zgjodhën në pozita qeveritare/komunale, liruan disa pozita të deputetëve të cilat duhej të zëvendësoheshin me kandidatët e ligjshëm në radhë për deputetë. Kësisoj, nga deputetët të cilët liruan ulëset e tyre u bënë zëvendësimet vijuese: kandidati Enver Haliti me 7,777 vota zëvendësoi deputetin Albin Kurti; kandidati Alban Hyseni me 7,767 vota zëvendësoi deputetin Glauk Konjufca; kandidatja Arta Bajralia me 7,674 vota zëvendësoi deputeten Albulena Haxhiu; kandidati Fitim Haziri me 7,542 vota zëvendësoi deputetin Arben Vitia; kandidati Eman Rrahmani me 7,044 vota zëvendësoi deputetin Haki Abazi. Më vonë, kandidati Taulant Kryeziu me 6968 vota zëvendësoi deputetin Shpejtim Bulliqi.

156. Domosdoshmëria e zëvendësimit të deputetëve aktivizoi në mënyrë automatike dispozitat ligjore të përcaktuara me nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – nen ky që specifikon mënyrën e zëvendësimit të deputetëve, me tekst vijues:

> *"112.2 Një anëtar i Kuvendit të Kosovës mandati i të cilit përfundon në pajtim me nenin 112.1 zëvendësohet si vijon:*
> *a) nga kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini i cili ka fituar numrin më të madh të votave të listës së riorganizuar të kandidatëve të Subjektit Politik në emër të së cilës garoi anëtari; [...]."*

157. Gjykata vëren se, sipas interpretimit që këtij neni i është bërë nga KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme, të gjitha zëvendësimet ishin bërë bazuar në kriterin e *"gjinisë"* dhe pa marrë parasysh rezultatin e arritur nga kandidatët për deputetë pas plotësimit të kuotës obligative ligjore për përfaqësim prej 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë. Kësaj mënyre të zëvendësimit të paraparë me ligj, sipas Gjykatës Supreme, nuk kanë mundur t'i shmangen as KQZ, as PZAP e as Gjykata Supreme ngase ekziston supozimi se ligjet janë në pajtim me Kushtetutën dhe se ato duhet zbatuar ashtu siç janë, *"deri sa nga Gjykata Kushtetuese të konstatohet se një ligj ose ndonjë dispozitë ligjore e tij është në kundërshtim me Kushtetutën"*.

158. Duke mos u pajtuar me këtë interpretim, parashtrueset e kërkesës dorëzuan kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese, nën pretendimin kyç se KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme e kanë zbatuar në mënyrë kundërkushtetuese mënyrën e zëvendësimit të deputetëve të paraparë me nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në thelb, ato pretenduan se përkundër plotësimit dhe tejkalimit të kuotës prej 30% nga kandidatet gra për deputete nga LVV – zëvendësimet për deputetë ishin bërë jo bazuar në rezultat zgjedhor por bazuar në gjini. Sipas tyre,

kjo gjë ka shkaktuar pabarazi në trajtim dhe shkelje të së drejtës së tyre për t'u zgjedhur.

159. Gjykata rikujton që, bazuar në mënyrën e zëvendësimit të aplikuar nga KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme, deputetët burra ishin zëvendësuar nga kandidatët burra për deputetë dhe deputetet gra ishin zëvendësuar nga kandidatet gra për deputete – përkundër faktit që parashtrueset e kërkesës kishin marrë më shumë vota se disa nga kandidatët burra që arritën të zgjedhën deputetë të Kuvendit. Parashtruesja e parë, Tinka Kurti kishte mbledhur 7655 vota dhe parashtruesja e dytë, Drita Millaku kishte mbledhur 7063.

160. Gjykata sqaroi se, nuk është duke vlerësuar *in abstracto* nëse neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është apo nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën. Kjo për faktin që, as para kësaj Gjykate e as para institucioneve paraprake publike që e kanë trajtuar këtë çështje, parashtrueset e kërkesës asnjëherë nuk kanë pretenduar që neni në fjalë është kundërkushtetues. Përkundrazi, parashtrueset e kërkesës vetëm kanë pretenduar që ky nen është zbatuar në mënyrë kundërkushtetuese nga KQZ, PZAP e Gjykata Supreme.

161. Duke marrë për bazë faktet e mësipërme dhe pretendimet e ngritura në këtë rast, Gjykata në këtë ankesë kushtetuese trajtoi faktin se: A është zbatuar neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nga ana e KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme, në përputhje me garancitë, vlerat dhe parimet e proklamuara me nenet 24 dhe 45 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së?

162. Gjykata Kushtetuese konstatoi se, interpretimi i këtij neni nga ana e KQZ-së, PZAP-it dhe Gjykatës Supreme nuk është interpretim i saktë dhe kushtetues për disa nga arsyet vijuese – të cilat janë gjerësisht të shtjelluara në Aktgjykim.

163. Së pari, Gjykata konstatoi se KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme, e kanë interpretuar nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në mënyrë të ngurtë e tekstuale dhe të shkëputur nga të gjitha normat e tjera ligjore të parapara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Barazi Gjinore si dhe parimet, vlerat dhe frymën e shkronjës së Kushtetutës. Ky lloj interpretimi ka abstrahuar kontekstin, qëllimin dhe arsyen e vendosjes së kuotës prej 30%, si masë e veçantë për të ndihmuar drejt arritjes së përfaqësimit të barabartë në mes të dy gjinive në Kuvendin e Republikës.

164. Së dyti, Gjykata potencoi se *ratio legis* i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron – në çdo rrethanë -përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë (cilado qoftë ajo). Mirëpo, qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të njërës gjini. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se, në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nënpërfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e ardhshme duhet të bëhen në bazë të renditjes të kandidatëve për deputetë, të cilën e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%, ndonëse ideali kushtetues dhe fryma e Kushtetutës, e reflektuar në nenin 7, synojnë arritjen e barazisë faktike 50% me 50% në mes të dy gjinive.

165. Së treti, Gjykata theksoi se interpretimi i nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme sipas mënyrës së interpretimit nga KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme, do të kishte kuptim vetëm në situatën kur mund të ndodhë që moszëvendësimet gjini-për-gjini (grua-për-grua ose burrë-për-burrë) do të mund të rrezikonin mospërmbushjen e kuotës ligjore prej 30% të përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar. Mirëpo, interpretimi i këtij neni, në mënyrën siç është bërë, kur dihet se në zgjedhjet e 6 tetorit 2019 kandidatet gra të subjektit politik LVV kishin arritur të merrnin vota meritore përtej përqindjes së kuotës ligjore prej 30%, është interpretim i gabuar i kësaj norme dhe në shpërputhje me vet qëllimin e kuotave ligjore të përcaktuara me nenin 27 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

166. Së katërti, Gjykata potencoi se qëllimi i vendosjes së kuotave ndërlidhet me nevojën për avancimin e barazisë gjinore brenda një shoqërie deri në arritjen e një barazie faktike, kur kuotat bëhen të panevojshme. Neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ekziston për një arsye të vetme: të paraqesë mënyrën e zëvendësimit të deputetëve – gjithnjë duke ruajtur qëllimin e përfaqësimit obligativ ligjor prej të paktën 30% të gjinisë pakicë. Nëse pas plotësimit të normës prej 30%, kandidatët nga gjinia pakicë (të nënpërfaqësuar) arrijnë të bëhen deputetë me forcat e tyre vetanake duke korrur rezultat më të mirë se sa pjesëtarët e gjinisë shumicë, atyre nuk duhet t'u mohohet e drejta për t'u zgjedhur deputetë të Kuvendit.

167. Gjykata konstatoi se, parashtruesja Tinka Kurti është diskriminuar në bazë të gjinisë në lidhje me të drejtën e saj për t'u zgjedhur, në momentin kur edhe përkundër përmbushjes së kuotës minimale 30% përmes rezultatit zgjedhor në kuadër të subjektit politik LVV, në

momentin kur u krijua mundësia e zëvendësimit të deputetëve, e njëjta edhe pse kishte më shumë vota se kandidatët burra për deputetë Fitim Haziri dhe Eman Rrahmani, nuk iu mundësua që të bëhej deputete.

168. Më tutje, Gjykata gjithashtu konstatoi se, parashtruesja Drita Millaku është diskriminuar në bazë të gjinisë në lidhje me të drejtën e saj për t'u zgjedhur, në momentin kur edhe përkundër përmbushjes së kuotës minimale 30% nëpërmjet rezultatit zgjedhor në kuadër të subjektit politik LVV, në momentin kur u krijua mundësia për zëvendësimet e ardhshme të deputeteve, përkatësisht kur dha dorëheqje deputeti Shpejtim Bulliqi, në vend të tij, në bazë të përcaktimit për zëvendësim në kuadër të gjinisë së njëjtë, më 18 dhjetor 2020, mandat deputeti mori kandidati Taulant Kryeziu me 6968 vota.

169. Si rrjedhojë, Gjykata konstatoi që: Aktvendimi [AA. nr. 4/2020] i 19 shkurtit 2020, i Gjykatës Supreme; Aktvendimi [AA. nr. 3/2020] i 19 shkurtit 2020, i Gjykatës Supreme; Vendimi i PZAP [Anr. 35/2020] i 13 shkurtit 2020; Vendimi i PZAP [Anr. 36/2020] i 13 shkurtit 2020; si dhe pika 5 e Vendimit të KQZ [nr. 102/A-2020] të 7 shkurtit 2020, janë në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

170. Përkitazi me efektin e Aktgjykimit, Gjykata vërejti se, për arsye objektive dhe në interes të sigurisë juridike, ky Aktgjykim nuk mund të prodhojë efekt juridik prapaveprues në lidhje me mandatet e deputetëve. Në këtë aspekt, Gjykata sqaroi se ky Aktgjykim nuk ka efekt prapaveprues dhe që në bazë të parimit të sigurisë juridike nuk prek të drejtat e palëve të treta të fituara në bazë të vendimeve të anuluara me këtë Aktgjykim. Megjithatë, kjo nuk nënkupton që ky Aktgjykim është thjesht deklarativ dhe pa asnjë efekt.

171. Efekti i parë i këtij Aktgjykimi është shfuqizimi i vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme, PZAP-it dhe KQZ-së, si të papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, në aspekt të interpretimit të nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Përmes shfuqizimit të këtyre vendimeve, ky Aktgjykim sqaron për të ardhmen se, bazuar në një lexim të saktë dhe kontekstual të nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, zëvendësimi i kandidatëve për deputetë duhet të bëhet në atë mënyrë që: *së pari*, të sigurohet përfaqësimi minimal në masën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar (gjinisë pakicë), e cila nuk mund të vihet në pikëpyetje në asnjë moment; dhe *së dyti*, në rastet kur kuota gjinore prej 30% është

përmbushur bazuar në rezultatin zgjedhor (siç ishte rasti konkret), atëherë zëvendësimet e kandidatëve për deputetë duhet të bëhen në bazë të rezultatit zgjedhor, pa u kufizuar në aspektin e zëvendësimit në bazë të gjinisë së njëjtë, përderisa nuk rrezikohet minimumi i përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar.

172. Efekti i dytë që ky Aktgjykim mundëson, ka të bëjë me të drejtën që iu lind parashtrueseve të kërkesëse ose palëve të tjera që mund të preken nga ky Aktgjykim, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij të fundit. Këtyre palëve iu lind e drejta për shfrytëzimin e mjeteve të tjera juridike në dispozicion për realizimin e mëtejmë të të drejtave në përputhje me gjetjet e këtij Aktgjykimi dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së të cituar në këtë Aktgjykim.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 26 mars 2021, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesat të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenit 14 (Ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm:

(i) Aktvendimet [AA. nr. 3/2020 dhe AA. nr. 4/2020] e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 19 shkurtit 2020;
(ii) Vendimet [Anr. 35/2020 dhe Anr. 36/2020] të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, të 13 shkurtit 2020;
(iii) Pikën 5 të Vendimit [nr. 102/A-2020] të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të 7 shkurtit 2020.

IV. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim nuk ka efekt prapaveprues dhe që në bazë të parimit të sigurisë juridike nuk prek të drejtat e palëve të treta të fituara në bazë të vendimeve të anuluara;

V. TË OBLIGOJË të gjitha autoritetet publike të Republikës së Kosovës që nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ta interpretojnë në pajtim me gjetjet e këtij Aktgjykimi;

VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VII. TË SHPALLË se ky Aktgjykim hyn në fuqi ditën e publikimit dhe dorëzimit të tij tek palët.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi

KI220/19, KI221/19, KI223/19 dhe KI234/19, Parashtrues: Sadete Koca Lila dhe të Tjerët; Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019

KI220/19, KI221/19, KI223/19 dhe KI234/19, Aktgjykim i 25 marsit 2021, publikuar më 8 prill 2021

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, mungesa e seancës dëgjimore, shkelje e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me privatizimin e Ndërmarrjes N.Sh. "Agimi" në Gjakovë dhe të drejtat respektive të punëtorëve për t'iu njohur statusi i punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga ky privatizim, siç është përcaktuar në nenin 68 (Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime) të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe paragrafin 4 të nenit 10 (Të Drejtat e të Punësuarëve) të Rregullores nr. 2003/13 e të ndryshuar me Rregulloren nr. 2004/45.

Parashtruesit e kërkesës nuk u përfshinë në Listën e Përkohshme të punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi". Të njëjtit në mënyrë individuale parashtruan ankesa pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Këto ankesa u refuzuan. Për pasojë, parashtruesit e kërkesës iniciuan padi në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, duke kontestuar Vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, përkitazi me vërtetimin e fakteve si dhe interpretimin e ligjit, duke pretenduar gjithashtu se ishin diskriminuar. Të gjithë parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore para Kolegjit të Specializuar.

Kolegji i Specializuar, kishte refuzuar kërkesën për seancë dëgjimore me arsyetimin se *"faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaft të qarta"*, duke u dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës, me përjashtim të dy prej tyre, dhe duke konstatuar se ishin diskriminuar, prandaj të njëjtit duhet të përfshihen në Listën Përfundimtare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Duke vepruar mbi bazën e ankesës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit kundër këtij Aktgjykimi, në gusht të vitit 2019, Kolegji i Apelit, kishte nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar, përmes të cilit kishte miratuar ankesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe e kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, duke hequr "*nga lista e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të NSH-së "Agimi" Gjakovë"* të gjithë parashtruesit e kërkesës. Këtë Aktgjykim, parashtruesit e kërkesës e kontestojnë para Gjykatës, duke pretenduar se i

njëjti është nxjerrë në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përkitazi me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashtruesit e kërkesës, pretendojnë se Kolegji i Apelit ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, (i) pa një seancë dëgjimore; (ii) pa arsyetim të mjaftueshëm; (iii) në interpretim arbitrar të ligjit; dhe (iv) në shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata u fokusua në ato që ndërlidhen me mungesën e një seancë dëgjimore para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, dhe në këtë kontekst, (i) fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore siç është e garantuar përmes Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe më pas, (ii) aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata, duke u bazuar ndër të tjerash, në Aktgjykimin të Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë,* sqaroi parimet kryesore që kanë të bëjnë me (i) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë; (ii) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë dhe të tretë; (iii) parimet në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme; dhe (iv) nëse mungesa e dëgjimit në shkallën e parë mund të korrigjohet përmes një seance dëgjimore në një shkallë më të lartë dhe kriteret përkatëse për të bërë këtë vlerësim. Për më tepër, Gjykata në mënyrë specifike shqyrtoi dhe aplikoi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut bazuar mbi të cilën bëhet vlerësimi nëse mungesa e një kërkese për seancë dëgjimore, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar e palëve nga një e drejtë e tillë.

Pas aplikimit të këtyre parimeve, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019 i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore, ndër të tjerash, sepse (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tyre nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtojë me nismën e tij domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore; (ii) parashtruesve të kërkesës iu është mohuar e drejta e seancës dëgjimore në të dy nivelet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme; (iii) Kolegji i Apelit, nuk kishte trajtuar "*çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike*", çështje

këto bazuar në të cilat do të mund të kishin ekzistuar "*rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*"; (iv) Kolegji i Apelit, në fakt, kishte shqyrtuar çështje "*fakti dhe ligji*", çështje këto shqyrtimi i të cilave, në parim, kërkon mbajtjen e një seance dëgjimore; dhe (v) Kolegji i Apelit, nuk kishte arsyetuar "*heqjen dorë nga seanca gojore*".

Për pasojë, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme, duhet të shpallet i pavlefshëm, dhe të kthehet në rivendosje në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Gjykata gjithashtu vuri theksin në faktin se konstatimi i saj për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet ekskluzivisht me mungesën e një seance dëgjimore, dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

Ndërsa, Gjykata lidhur me kërkesat e parashtruesve të kërkesës KI221/19 (Muhamet Domi) dhe KI234/19 (Fikrije Nuka) i refuzoj si qartazi te pabazuar siç specifikohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, për shkak se nuk kanë ofruar ndonjë provë që ankesat e tyre janë përjashtuar nga procedura e vlerësimit në DHPGJS.

AKTGJYKIM

në

rastet nr. KI220/19, KI221/19, KI223/19 dhe KI234/19

Parashtrues

Sadete Koca Lila dhe të tjerët

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa KI220/19 është dorëzuar nga Sadete Koca Lila, me banim në Gjakovë; Kërkesa KI221/19 është dorëzuar nga Muhamet Domi, me banim në Gjakovë; Kërkesa KI223/19 është dorëzuar nga Afrim Meka, me banim në Gjakovë; Kërkesa KI234/19 është dorëzuar nga Fikrije Nuka me banim në Gjakovë;(në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i DHPGJS).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 6 dhjetor 2019, parashtruesit e kërkesës Sadete Koca Lila dhe Muhamet Domi i dorëzuan përmes postës kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës Afrim Meka e dorëzoi përmes postës kërkesën e tij në Gjykatë.

7. Më 20 dhjetor 2019, parashtruesja e kërkesës Fikrije Nuka e dorëzoi përmes postës kërkesën e saj në Gjykatë.

8. Më 20 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi për rastin KI220/19 gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

9. Më 23 dhjetor 2019, në pajtim me paragrafin (1) të rregullit 40 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI221/19 dhe KI223/19 me kërkesën KI220/19.

10. Më 30 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI234/19 me kërkesat KI220/19, KI221/19 dhe KI223/19.

11. Më 21 janar 2020, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës, si dhe DHPGJS për regjistrimin e kërkesave dhe bashkimin e tyre.

12. Më 10 qershor 2020, Gjykata kërkoi nga parashtruesit e kërkesës Muhamet Domi dhe Fikrije Nuka që të dorëzojnë në Gjykatë të gjitha kopjet e kërkesave/ankesave drejtuar Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

13. Më 19 qershor 2020, parashtruesja e kërkesës Fikrije Nuka dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë.

14. Më 23 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës Muhamet Domi dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë.

15. Më 2 shtator 2020, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen ta shtyjë për një seancë tjetër në përputhje me plotësimet e kërkuara.

16. Më 25 mars 2021, Gjykata me shumicë konstatoi se (i) kërkesat nr. KI220/19 dhe KI223/19, janë të pranueshme; (ii) për kërkesat nr. KI220/19, KI223/19, ka pasur shkelje te nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe te Paanshëm] te Kushtetutës se Republikës se Kosovës ne lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe, (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 te Kolegjit te Apelit te DHPGJS-së.

17. Në të njëjtën ditë, Gjykata shpalli të papranueshme kërkesat nr. KI221/19 me parashtrues të kërkesës Muhamet Domi dhe KI234/19 me parashtrues të kërkesës Fikrije Nuka.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 15 shtator 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) kishte privatizuar ndërmarrjes shoqërore NSH "Agimi" në Gjakovë. Të gjithë parashtruesit e kërkesës ishin punëtorë të ndërmarrjes në intervale të caktuara kohore.

19. Më 22 dhjetor 2011, përmes mjeteve të informimit publik: (i) u publikua Lista e Përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e 20%-it nga privatizimi i NSH "Agimi", Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Lista Përfundimtare), si dhe (ii) u

përcaktua 14 janari 2012 si datë e fundit e dorëzimit të ankesave në DHPGJS kundër Listës Përfundimtare.

20. Ndërmjet 28 dhjetorit 2011 dhe 13 janarit 2012, parashtruesit e kërkesës në mënyrë individuale parashtruan padi në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS, për shkak të mospërfshirjes në Listën Përfundimtare.

21. Ndërmjet 1 marsit 2012 dhe 18 prillit 2012, AKP paraqiti përgjigje në paditë individuale të parashtruesve të kërkesës, kryesisht për: (i) mos ofrim të provave të mjaftueshme përmes të cilave do vërtetohej kontinuiteti i marrëdhënies së punës dhe se (ii) në kohën e privatizimit të ndërmarrjes, parashtruesit e kërkesës nuk ishin të regjistruar si punëtorë në NSH "Agimi".

22. Ndërmjet 3 prillit 2012 dhe 3 majit 2012, disa nga parashtruesit e kërkesës paraqitën shkresa me informata plotësuese lidhur me statusin e punëtorit në NSH "Agimi".

23. Më 4 shtator 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin [SCEL-11-0075] përmes të cilit: [...]; "II. *Ankesat e ankuesve të cekur në pikën II duhet të përfshihen në Listën Përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e 20%-it nga privatizimi i NSH "Agimi", Gjakovë*; [...], 32. Sadete Koci Lila (C 0022-05), 53. Afrim Meka (C0023-12), [...]; III. *Ankesat e ankuesve të cekur në pikën III refuzohen si të pabazuara".*

24. Më 13 shtator 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS nxori Aktvendimin [SCEL-11-0075] përmes së cilit korrigjoi Aktgjykimin [SCEL-11-0075] e 4 shtatorit 2013, pasi që me rastin e përcjelljes së një kopje të aktgjykimit në versionin e gjuhës angleze në vend që tu përcillet aktgjykimi përfundimtar palëve u ishte përcjellë aktgjykimi preliminar ndërsa versioni në gjuhën shqipe mbeti i pandryshuar.

25. Përkitazi me parashtruesit e kërkesave të pikës II të Aktgjykimit [SCEL-11-0075], përkatësisht parashtruesit e kërkesave: KI220/19, dhe KI223/19, Kolegji i Specializuar i DHPGJS sqaroi se gjatë viteve të 90-ta atyre u ishte ndërprerë marrëdhënia e punës dhe janë larguar nga puna duke u zëvendësuar me punëtorë serb çka është "ngjarje e ditur botërisht" dhe se rrjedhimisht janë diskriminuar. Prandaj të njëjtit duhej të përfshihen në listën përfundimtare për të fituar të drejtën e 20%-it secili veç e veç.

26. Ankesat e punëtorve të tjerë në pikën III të Aktgjykimit [SCEL-11-0075] ishin refuzuar si të pabazuara sepse të njëjtit nuk kishin dorëzuar asnjë dëshmi për shqyrtim dhe administrim siç parashihej me paragrafin 4 të nenit 10 (të drejtat e të punësuarve) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45 që përcakton se punëtorët që konsiderohen legjitim për pjesëmarrje në 20% të fitimit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore duhet të dëshmojnë se: (i) janë punëtorë të regjistruar të ndërmarrjes shoqërore përkatëse në kohën e privatizimit; dhe, (ii) se kanë qenë në listën e pagave të ndërmarrjes shoqërore për jo më pak se tre (3) vjet.

27. Më 30 shtator 2013, AKP parashtroi ankesë kundër pikës II të Aktgjykimit [SCEL-11-0075] të 4 shtatorit 2013, të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, për shkak të (i) vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe (ii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin e anulimit të pikës II të Aktgjykimit të lartpërmendur. Sipas AKP-së asnjë ankues i cili me aktgjykimin e atakuar është përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Agimi" nuk ka prezantuar fakte relevante në bazë të cilave kishte për ta vërtetuar faktin e trajtimit të pabarabartë dhe arsyetimin për diskriminim direkt apo të tërthortë në pajtim me paragrafin 1 të nenit 8 (barra e provave) të Ligjit Kundër Diskriminimit.

28. Më 29 gusht 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS nxori Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008], përmes së cilit vendosi [...] "*2. Ankesat e ankuesve*, [...] *refuzohen si të pabazuara. 3. Ankesa A002 e AKP-së, aprovohet si e bazuar lidhur me punëtorët:* [...],C-0022-05-Sadete Koci Lila, [...], C-0023-12-Afrim Meka, [...],*të njëjtit hiqen nga lista e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të NSH-së "Agimi" Gjakovë. [...] 5. Nuk caktohet taksa gjyqësore për procedurën ankimore".*

29. Ankesat e parashtruesve të kërkesës të cilat u refuzuan si të pabazuara në pikën 2 të Aktgjykimit [AC-I-13-0181-A0008] të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, konsistonin në arsye të njëjta të dhëna edhe nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS. Pra, parashtruesit e lartpërmendur të kërkesave nuk kishin dorëzuar dëshmi për të provuar kërkesat e tyre me qëllim që tu njihej e drejta për përfshirje në listën përfundimtare të 20% të NSH "Agimi", shqyrtim dhe administrim ky që parashihej me paragrafin 4 të nenit 10 (të drejtat e të punësuarve) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45. Kjo Rregullore përcaktonte se punëtorët që konsiderohen legjitim për pjesëmarrje në 20% të fitimit të privatizimit të

ndërmarrjeve shoqërore duhet të dëshmojnë se: (i) janë punëtorë të regjistruar të ndërmarrjes shoqërore përkatëse në kohën e privatizimit; dhe, (ii) se kanë qenë në listën e pagave të ndërmarrjes shoqërore për jo më pak se tri (3) vite.

30. Sa i përket aprovimit të ankesës së AKP-së si të bazuar, me ç 'rast parashtruesit e kërkesës KI220/19 dhe KI223/19 hiqen nga lista e përfituesve, Kolegji i Apelit i DHPGJS thekson që nuk pajtohet me qasjen e ndjekur nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS lidhur me interpretimin e diskriminimit, të cilën e trajtoi si të papërputhshme me të 'drejtën precedentale'. Sipas tyre e drejta precedentale e DHPGJS-së (ASC-11-0069, AC-I-12-0012), përcakton që të diskriminuar mund të llogariten: a) punëtorët e përkatësisë etnike shqiptare, apo që u takojnë minoriteteve ashkali, romë, egjiptianë, goranë dhe turq, të cilët ishin larguar për arsye diskriminimi në periudhën e ashtuquajtur të "masave të përkohshme serbe" (që sillet prej vitit 1989 deri në vitin 1999), apo të cilët u diskriminuan edhe në periudha të ndryshme, për shkak të etnisë së tyre, besimeve politike dhe religjioze, etj.; b) punëtorët e përkatësisë etnike serbe të cilët për shkak të mungesës së sigurisë pas vitit 1999, nuk u paraqitën në punë dhe të njëjtit nuk u gjendën në listat përfundimtare të punëtorëve.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

31. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS [AC-I-13-0181-A0008] të 29 gushtit 2019, u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), si dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.

32. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës fillimisht theksojnë se të gjithë kanë qenë punëtorë të NSH "Agimi", dhe se kjo vërtetohet edhe përmes shkresës së AKP-së e cila u është drejtuar më 15 shtator 2010, përmes të cilës janë njoftuar se si rezultat i privatizimit të ndërmarrjes në fjalë, janë ndërprerë të gjitha marrëdhëniet përkatëse të punës, dhe se rrjedhimisht të njëjtit, i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores 2003/03 për të përfituar nga njëzet përqindëshi (20%-it) i privatizimit të ndërmarrjes përkatëse. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ata kanë dorëzuar provat në dispozicion, por që "*prova përkatëse kanë qenë në disponim të Zyrës kadrovike të Sh.A. "Agimi"*

në Gjakovë e më pastaj të stafit të emëruar nga AKP-ja, punëtor të ish-Sh.A. ose N.SH "Agimi" Gjakovë".

33. Të njëjtit, në esencë, pretendojnë se Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara përmes neneve të lartcekura sepse i njëjti (i) ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe i cili ka qenë në favor të parashtrueseve të kërkesës, pa një seancë dëgjimore, duke mos u mundësuar të njëjtëve për tu deklaruar rreth fakteve kontestuese, duke theksuar se "*është e vërtetë që Dhoma e Posaçme ka mundësi të mban gjykim edhe pa prezencën e palëve, por është gjithashtu e vërtetë se ka të drejtë që të caktoj seancë publike dhe në atë do të i epej mundësia Gjykatës dhe palëve të ballafaqojnë parashtrimet dhe provat, do të bëhej një gjykim i hapur, i drejtë dhe transparent që do të argumentoheshin faktet relevante*"; (ii) për dallim prej Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, ngërthen interpretim arbitrar përkitazi me diskriminimin sepse barra e të provuarit lidhur me pretendimet për diskriminim bazuar në nenin 8 të Ligjit kundër Diskriminimit i takon AKP-së; (iii) nuk është i arsyetuar; dhe (iv) ka shkelur të drejtat e tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

34. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ata nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë me punëtorët e tjerë të NSH "Agimi", "*situata juridike dhe faktike*" e të cilëve është identike me parashtruesit e kërkesës, ndërsa Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, i ka trajtuar pretendimet e tyre në kuptim të diskriminimit etnik, duke u referuar në të "*drejtën precedentale*".

35. Sa i përket parashtruesve të kërkesave KI221/19 dhe KI234/19, respektivisht Muhamet Domi dhe Fikrije Nuka, përveç pretendimeve të lartcekura ata pretendojnë se edhe pse kanë parashtruar ankesë pranë DHPGJS, ata me "*gabim nuk janë përfshirë në procedurë dhe nuk iu është refuzuar dhe as pranuar ankesa e tyre*".

36. Përfundimisht parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata: (i) t'i deklarojë kërkesat të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; (iii) ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, dhe të njëjtin ta kthejë për rigjykim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

[...]

Neni 24
[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë

kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

LIGJI Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 10
Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet

[...]
11. Në rastet kur kolegji i apelit pranon dhe merr përsipër vendosjen mbi një apel, rregullat në vijim respektohen fuqimisht: 11.1. kolegji i apelit nuk mund të ndryshojë, anulojë, rikthejë apo përndryshe të ndërrojë, në çfarëdo mënyrë, gjetjet faktike të bëra nga një gjykatë, kolegj i specializuar, nën-kolegj apo gjyqtar i vetëm, përveç nëse kolegji i apelit përcakton që ajo gjetje faktike është qartësisht e gabueshme. Gjetja faktike nuk vlerësohet të jetë qartësisht e gabueshme nëse ajo gjetje faktike mbështetet me interpretim të arsyeshëm të dosjes së procedurave gjyqësore dhe provave të parashtruara gjatë atyre procedurave; si dhe 11.2. kolegji i apelit bën shqyrtim, prej fillimit, të secilës çështje që ngrihet nga apeluesi apo pala kundërshtare në parashtresat e tij/saj me shkrim.
[...]

Shtojca e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Rregullorja e Punës e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 36
Rregullat e përgjithshme mbi provat

[...]
3. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të

paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Neni 68
Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime

1. Përveç nëse nuk përcaktohet saktësisht me këtë nen, procedura për lëndët që bazohen në ankesat që bien nën paragrafin 1.6. të nenit 4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme do të ndjek rregullat e tjera procedurale të përshkruara në këtë Shtojcë e që Dhoma e Posaçme i zbaton mutatis mutandis nëse i vlerëson si të domosdoshme dhe në interes të drejtësisë.
2. Pas pranimit të listës së të punësuarve me të drejta legjitime në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo në bazë të çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas datës së shpalljes, duke kërkuar përfshirjen në një listë të tillë dhe/apo duke sfiduar përfshirjen e një apo më shumë personave tjerë në një listë të tillë. Personi i cili parashtron një kërkesë apo kundërshtim të tillë, do të përfshijë aty në deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështesin kërkesën apo kundërshtimin e tillë; ai person ka barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në kërkesë dhe/apo në kundërshtim.
[...]
6. Agjencia shpallë listën e saj përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime në mbështetje të paragrafit 5. të këtij neni e në përputhje me nenin 10.6. të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, ose në pajtim me çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas ditës së shpalljes për të kundërshtuar në listë të tillë dhe/apo në lidhje me shpërndarjen e fondeve të mbledhura nga Agjencia për personat e identifikuar në atë listë. Ankuesi(t) që parashtrojnë një ankesë të tillë përfshijnë një deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështetin ankesën e tillë; personat që ankohen kanë barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në ankesë.
[...]
11. Kolegji gjegjës i Specializuar, me nismë të vet apo në bazë të një kërkese me shkrim nga ankuesi(t) apo Agjencia, mund të vendos për mbajtjen e një apo më shumë seancave gojore lidhur me çështjen. Nëse mbahet një seance gojore, atëherë Kolegji

Specializuar do të udhëzojë Regjistër mbajtësin që, së paku pesë (5) ditë më herët para seancës gojore, t"i dorëzojë palëve një njoftim me shkrim për kohën dhe ditën e seancës së tillë.
[...]
14. Kolegji i Apelit zgjidhë të gjitha apelet e tilla urgjentisht.

Neni 64
Procedurat e ankesës me gojë

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkese për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.
[...]

Neni 65
Paraqitja e provave të reja

Në rrethana të jashtëzakonshme dhe për arsye që dëshmohen mirë, Kolegji i Apelit mund t"i lejoj një pale paraqitjen e provave të reja që nuk kanë qenë në dispozicion të palës gjatë procedurës së shkallës së parë për vlerësimin e provave. Kërkesa me shkrim për një leje të tillë duhet së pari t"i dorëzohet Kolegjit të Apelit dhe duhet t"i dorëzohet palëve tjera jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së seancës kur propozohet paraqitja e këtyre provave. Kolegji i Apelit mund të autorizojë paraqitjen e provave të reja nëse vlerëson se në këtë mënyrë drejtësia do të vihet në vend.

Rregullore nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore

Neni 10
Të Drejtat e të Punësuarve

[...]
10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë

nuk i ndalon punëtorët, të cilit pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qënë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.
[...]

Rregullore Nr. 2004/45 për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2003/ 13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore

Neni 1
Ndryshimet

Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje,
[...]
B. Nenet 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 ndryshohen si vijon:
[...]
10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit apo të fillimit të procedurës së likuidimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vite. Kjo kërkesë nuk i përjashton punëtorët nga paraqitja e ankesës në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6., të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar po të mos kishin qenë të diskriminuar.
[...]

Ligji Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 69
Procedurat e ankesës me gojë

1. *Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkese për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.*
[...]

Ligji Nr. 2004/3 kundër Diskriminimit

Neni 8
Barra e Provave

8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.
8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda te tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore.

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesat i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

39. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale) dhe 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të
ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ... ".

40. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (2) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që specifikon:

"[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

41. Për sa i përket kërkesës KI221/19 (Muhamet Domi) dhe KI234/19 (Fikrije Nuka) të cilët pretendojnë se kanë parashtruar ankesë pranë DHPGJS, por ata me "*gabim nuk janë përfshirë në procedurë dhe nuk iu është refuzuar dhe as pranuar ankesa e tyre"*.

42. Gjykata rikujton se, përmes shkresës se 10 qershorit 2020, kishte kërkuara nga parashtruesit e kërkesës KI221/19 (Muhamet Domi) dhe KI234/19 (Fikrije Nuka) që të dorëzojnë të gjitha kopjet e ankesave drejtuara DHPGJS në mënyre që të mbështetin pretendimin tyre se

kjo e fundit i kishte përjashtuar nga vlerësimi ankesat e tyre. Parashtruesit e kërkesës KI 221/19 (Muhamet Domi) dhe KI234/19 (Fikrije Nuka) dorëzuan në gjykatë dokumente shtese por që nuk adresonin kërkesat e gjykatës.

43. Gjykata thekson se parashtruesit KI221/19 (Muhamet Domi) dhe KI234/19 (Fikrije Nuka) nuk kanë arritur që të provojnë para Gjykatës se ata kanë deponuar ndonjë ankesë/kërkesë në DHPGJS dhe se kjo e fundit i ka përjashtuar nga procedura e vlerësimit ankesat e tyre. Gjithashtu, Gjykata vëren se parashtruesit e lartcekur nuk kanë arritur që të dorëzojnë në Gjykatë as kopjet e ankesave të pretenduara, të cilat sipas tyre i ishin drejtuar/dorëzuar DHPGJS.

44. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesve të kërkesës KI221/19 (Muhamet Domi) dhe KI234/19 (Fikrije Nuka) duhet të refuzohet qartazi e pabazuar siç specifikohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

45. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave të parashtruesve të tjerë, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesave janë palë të autorizuara, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe i kanë dorëzuar kërkesat në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

46. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

47. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me privatizimin e ndërmarrjes shoqërore NSH "Agimi" në Gjakovë, dhe të drejtat e punëtorëve përkatës për t'iu njohur statusi i punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga ky privatizim, siç është përcaktuar në nenin

68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, dhe paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13 e të ndryshuar me Rregulloren nr. 2004/45. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se ndërmarrja e lartcekur shoqërore ishte privatizuar më 15 shtator 2010, datë kjo në të cilën gjithashtu parashtruesit e kërkesës përmes shkresave individuale ishin njoftuar se "*pasoja shitjes së aseteve kryesore është përfundimi i punësimit tuaj*" dhe se i njëjti "*përfundon menjëherë*". Parashtruesit e kërkesës më pas kishin kontestuar mospërfshirjen e tyre në Listën e Përkohshme të AKP-së për punëtorët me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi". Këto ankesa ishin refuzuar. Në vijim, parashtruesit e kërkesës kishin iniciuar padi në Kolegjin e Specializuar, duke kontestuar Vendimin e AKP-së, edhe përkitazi me vërtetimin e fakteve edhe interpretimin e ligjit. Të njëjtit kishin pretenduar se ishin diskriminuar dhe të gjithë kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore para Kolegjit të Specializuar. Ky i fundit, kishte refuzuar kërkesën për seancë dëgjimore me arsyetimin se *"faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaft të qarta"*, dhe u kishte dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës. Kolegji i Specializuar, gjithashtu ndër të tjera, kishte theksuar se në mungesë të diskriminimit, parashtruesit e kërkesës, do t'i kishin plotësuar kriteret e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr.2003/13, si punëtorë me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi".

48. Pas nxjerrjes së këtij Aktgjykimi, ankesë në Kolegj të Apelit kishte paraqitur AKP-ja duke kërkuar anulimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar. AKP-ja, nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. Në gusht të vitit 2019, Kolegji i Apelit, kishte nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe për pasojë, duke hequr "*nga lista e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të NSH-së "Agimi" Gjakovë",* të gjithë parashtruesit e kërkesës. Kolegji i Apelit, fillimisht kishte theksuar se kishte vendosur të *"heq dorë nga pjesa e seancës gojore",* duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 (Procedura e ankesës me gojë) të Ligjit nr. 06/L-086 për DHPGJS-në. Ndërsa, përkitazi me meritat e çështjes, (i) kishte konstatuar se provat e paraqitura nga palët përkatëse nuk dëshmojnë se të njëjtit i plotësojnë kushtet ligjore të përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13 për t'iu njohur të drejtat përkatëse; dhe (ii) kishte theksuar se interpretimi i diskriminimit nga Kolegji i Specializuar është në kundërshtim me "*të drejtën precedentale*" të DHPGJS-së. Këto konstatime të Kolegjit të Apelit, parashtruesit e kërkesës i kontestojnë para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim

të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Përkitazi me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës, siç është sqaruar më lart, pretendojnë se Kolegji i Apelit e ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, (i) pa një seancë dëgjimore; (ii) pa arsyetim të mjaftueshëm; (iii) në interpretim arbitrar të ligjit; dhe (iv) në shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

49. Këto kategori pretendimesh, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

50. Gjykata, në këtë aspekt, fillimisht do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesëve të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit. Për këtë qëllim, në vijim, Gjykata fillimisht (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore siç është e garantuar përmes neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së; dhe më pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(iii) Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore

51. Karakteri publik i procedurave para organeve gjyqësore të referuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, mbron palët ndërgjyqëse nga administrimi i drejtësisë në fshehtësi, në mungesë të një shqyrtimi publik. Publiciteti i procedurave gjyqësore është gjithashtu një nga mekanizmat kryesorë përmes të cilës ruhet besimi në drejtësi. Një parim i tillë, për më tepër, kontribuon në arritjen e qëllimeve të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike të mishëruara në Kushtetutë dhe KEDNJ (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 381 deri 404 dhe referencat e përdoruara aty).

52. Në parim, palët ndërgjyqëse kanë të drejtë për një seancë dëgjimore publike, por një detyrim i tillë nuk është absolut. Për aq sa është

relevante për rrethanat e tanishme, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka zhvilluar parimet kryesore që kanë të bëjnë me (i) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë; (ii) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë dhe të tretë; (iii) parimet në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme; dhe (iv) nëse mungesa e dëgjimit në shkallën e parë mund të korrigjohet përmes një seance dëgjimore në një shkallë më të lartë dhe kriteret përkatëse për të bërë këtë vlerësim. Sidoqoftë, në të gjitha rrethanat, mungesa e një seancë dëgjimore duhet të jetë e arsyetuar nga gjykata përkatëse.

53. Për sa i përket çështjes së parë, përkatësisht detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë, GJEDNJ ka theksuar se në procedurat para një gjykate të shkallës së parë dhe të vetme, e drejta për një seancë dëgjimore është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Fredin kundër Suedisë (nr. 2)*, Aktgjykim i 23 shkurtit 1994, paragrafët 21-22; *Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2)*, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 46; *Göç kundër Turqisë*, Aktgjykim i 11 korrikut 2002, paragrafi 47; dhe *Selmani dhe të tjerët kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Aktgjykim i 9 shkurtit 2017, paragrafët 37-39). Përjashtim nga ky parim i përgjithshëm, përbëjnë rastet në të cilat "*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*" në shkallën e parë dhe të vetme (shih, në këtë aspekt, rastet e GJEDNJ-së, *Hesse-Anger dhe Anger kundër Gjermanisë*, Vendim i 17 majit 2001; dhe *Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë*, Aktgjykim i 13 marsit 2018, paragrafi 36; e shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 382 dhe referencat e përdoruara aty). Karakteri i rrethanave të tilla të jashtëzakonshme buron nga natyra e çështjeve që ngërthen një rast, për shembull, rastet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës shumë teknike (shih rastin e GJEDNJ-së, *Koottummel kundër Austrisë*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009, paragrafët 19 dhe 20).

54. Për sa i përket çështjes së dytë, përkatësisht detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Salomonsson kundër Suedisë*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 36). Prandaj, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat

përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miller kundër Suedisë*, Aktgjykim i 8 shkurtit 2005, paragrafi 30; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 383 dhe referencat e përdoruara aty). Thënë këtë, dhe në parim, mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet vetëm përmes "*ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme*", siç janë definuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në të kundërtën një e tillë është e garantuar për palët në të paktën njërin nivel të juridiksionit, bazuar në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 386 dhe referencat e përdoruara aty).

55. Për sa i përket çështjes së tretë, përkatësisht parimeve në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme, Gjykata i referohet Aktgjykimit të 6 nëntorit 2018 të GJEDNJ-së: *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, në të cilin Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së, vendosi parimet bazuar në të cilat duhet të vlerësohet domosdoshmëria e një seance dëgjimore. Sipas këtij Aktgjykimi, një seancë dëgjimore nuk është e domosdoshme nëse rasti përkatës (i) ngërthen thjeshtë çështje juridike të një natyre të kufizuar (shih rastet e GJEDNJ-së, *Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2)*, cituar më lart, paragafi 49; dhe *Valová, Slezák dhe Slezák kundës Sllovakisë*, Aktgjykim i qershorit 2004, paragrafët 65-68) ose nuk ngërthen ndonjë ndërlikueshmëri të veçantë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Varela Assalino kundër Portugalisë,* Vendim i 25 prillit 2002); (ii) ngërthen çështje tepër teknike, të cilat trajtohen më mirë me shkrim sesa përmes argumenteve gojore në një seancë dëgjimore; dhe (iii) nuk ngërthen çështje të besueshmërisë së palëve ose fakteve të kontestuara dhe gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme në bazë të parashtresave të palëve dhe materialeve të tjera me shkrim (shih rastet e GJEDNJ-së, *Döry kundër Suedisë*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 37; dhe *Saccoccia kundër Austrisë*, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008, paragrafi 73).

56. Në të kundërtën, bazuar në Aktgjykimin e lartpërmendur, një seancë dëgjimore është e domosdoshme nëse rasti përkatës (i) ngërthen nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të

ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë (shih, ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *Malhous kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 60; dhe *Fischer kundër Austrisë*, Aktgjykim i 26 prillit 1995, paragrafi 44); dhe (ii) kërkon që gjykata përkatëse të fitojë një përshtypje personale për palët përkatëse, dhe t'u lejohet të njëjtëve mundësia të sqarojnë gjendjen personale, personalisht ose përmes përfaqësuesit përkatës. Shembuj të kësaj situate përbëjnë rastet kur gjykata duhet të dëgjojë prova nga palët në lidhje me vuajtjet personale në mënyrë që të përcaktojë nivelin e duhur të kompensimit (shih rastet e GJEDNJ-së, *Göç kundër Turqisë,* cituar më lart, paragrafi 51; dhe *Lorenzetti kundër Italisë,* Aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafi 33) ose duhet të sigurojë informacion në lidhje me karakterin, sjelljen dhe rrezikshmërinë e një pale (shih rastin e GJEDNJ-së, *De Tommaso kundër Italisë*, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafi 167).

57. Për sa i përket çështjes së katërt, përkatësisht mundësisë së korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë dhe kritereve respektive, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar se në parim, një korrigjim i tillë varet nga kompetencat e gjykatës më të lart. Nëse kjo e fundit, ka juridiksion të plotë për të shqyrtuar meritat e rastit përkatës, përfshirë edhe vlerësimin e fakteve, atëherë korrigjimi i mungesës së një seance dëgjimore në shkallë të parë, mund të bëhet në shkallën e dytë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë,* cituar më lart, paragrafi 192 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafin 384 dhe referencat e përdoruara aty).

58. Përfundimisht, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, fakti që palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore nuk do të thotë që të njëjtat kanë hequr dorë nga e drejta për të mbajtur një të tillë (për më shumë, lidhur me heqjen dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore, shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 401 dhe 402 dhe referencat e përdorura aty). Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, një çështje e tillë varet nga karakteristikat e ligjit vendor dhe rrethanat e secilit rast veç e veç (shih rastin e GJEDNJ-së, *Göç kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 48; dhe shih, gjithashtu, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafi 403 dhe referencat e përdorura aty).

(iv) Aplikimi i parimeve të shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret

59. Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së, në parim, garanton mbajtjen e një seance dëgjimore në të paktën njërin nivel të vendimmarrjes. Një e tillë është, në parim, (i) e detyrueshme nëse gjykata e shkallës së parë ka kompetencën e vetme të vendimmarrjes përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit; (ii) jo e detyrueshme në shkallë të dytë nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallë të parë, përkundër faktit që një përcaktim i tillë varet nga karakteristikat e rastit përkatës, për shembull, nëse shkalla e dytë vendos edhe për çështje fakti edhe ligji; dhe (iii) e detyrueshme në shkallë të dytë nëse një e tillë nuk është mbajtur në shkallë të parë, në rastet kur shkalla e dytë ka kompetencë të plotë për të vlerësuar vendimin e shkallës së parë, edhe përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit. Përjashtime nga këto raste, në parim, bëhen vetëm nëse *"ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore"*, dhe të cilat GJEDNJ, siç është sqaruar më lart, përmes praktikës së saj gjyqësore i ka përcaktuar si raste që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës së lartë teknike.

60. Bazuar në parimet e shtjelluara më lart, Gjykata në vijim fillimisht duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar një seancë dëgjimore në Kolegjin e Apelit, mund të rezultojë në konstatimin se të njëjtit kanë hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga një seancë dëgjimore. Nëse përgjigja në këtë çështje rezulton të jetë negative, atëherë Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret *"ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore"* në të dy shkallët e vendimmarrjes, para Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit, respektivisht. Këtë vlerësim Gjykata do të bëjë duke u bazuar edhe në parimet e vendosura përmes Aktgjykimit të Dhomës së Madhe *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë.*

c) Nëse parashtruesit e kërkesës kanë hequr dorë nga e drejta e një seance dëgjimore

61. Gjykata në këtë aspekt, fillimisht rikujton që përmes ankesave individuale të parashtruara në Kolegjin e Specializuar, të gjithë parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. Kolegji i Specializuar kishte refuzuar mbajtjen e të njëjtës,

duke theksuar se bazuar në paragrafin 11 të nenit 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-së, seanca dëgjimore nuk ishte e nevojshme sepse "*faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaftë të qarta*". Siç, është sqaruar tashmë, Kolegji i Specializuar, bazuar në këto *"fakte dhe prova"*, kishte vendosur se parashtruesit e kërkesës ishin diskriminuar duke vendosur gjithashtu se të njëjtit duhet të përfshihen ne Listën Përfundimtare të AKP-së si punëtorë me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) të privatizimit të ndërmarrjes NSH "Agimi".

62. Në Kolegjin e Apelit ishte ankuar AKP. Kolegji i Apelit kishte vendosur në favor të AKP-së, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe duke refuzuar ankesat e të gjithë parashtruesve të kërkesës përkitazi me mospërfshirjen në Listën Përfundimtare të AKP-së si rezultat i diskriminimit. Siç është sqaruar më lart, Kolegji i Apelit kishte vendosur të *"heq dorë nga pjesa e seancës gojore",* duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 të Ligjit nr. 06/L-086për DHPGJS-në. Parashtruesit e kërkesës, të cilët kishin paraqitur dokumente shtesë në përgjigje të ankesës së AKP-së ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, nuk kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore.

63. Megjithatë, siç është sqaruar më lart, fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë bërë kërkesë për një seancë dëgjimore, jo detyrimisht do të thotë se të njëjtit kanë hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga një kërkesës e tillë, dhe gjithashtu mungesa e kësaj kërkese jo detyrimisht e liron gjykatën përkatëse nga detyrimi për mbajtjen e një seancë të tillë.

64. Më saktësisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në rrethanat e rasteve në të cilat palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seancë dëgjimore, GJEDNJ, ndër tjerash vlerëson nëse mungesa e një kërkesë të tillë, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar të një parashtruesi nga e drejta për një seancë dëgjimore. Thënë këtë, mungesa e kërkesës për një seancë dëgjimore, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, asnjëherë nuk është faktori i vetëm që determinon domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance dëgjimore. Në të gjitha rastet, nëse mungesa e kërkesës për seancë dëgjimore e liron një gjykatë nga detyrimi për mbajtjen e një seancë dëgjimore, varet nga (i) specifikat e ligjit të aplikueshëm; dhe (ii) rrethanat e një rasti (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 401 deri 404 dhe referencat e përdoruara aty). Në vijim, Gjykata do të vlerësojë këto dy kategori çështjesh.

65. Së pari, përkitazi me specifikat e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht Ligjit dhe Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Gjykata rikujton se bazuar në nenin 64 (Procedurat e ankesës me gojë) të të njëjtit ligj, "*Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse*", në bazë të nismës së tij apo edhe kërkesës me shkrim nga një palë. Neni 69 (Procedurat e ankesës me gojë) i Ligjit Nr. 06/L-086 për DHPGJS-në, ka të njëjtën përmbajtje. Bazuar në këto dispozita rrjedhimisht, mbajtja e një seance dëgjimore në nivel apeli, jo detyrimisht varet nga kërkesa e palës. Është gjithashtu detyrë e Kolegjit përkatës, që bazuar në nismën e tij, të vlerësojë nëse rrethanat e një rasti kërkojnë mbajtjen e një seance dëgjimore. Për më tepër, bazuar në nenin 60 (Përmbajtja e ankesës) dhe nenin 65 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të vlerësojë edhe çështjet e ligjit edhe të faktit, dhe për pasojë, është e pajisur me kompetencë të plotë për të vlerësuar mënyrën se si ka vlerësuar faktet autoriteti më i ulët, përkatësisht Kolegji i Specializuar. Në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Apelit ka vlerësuar faktet dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar edhe përkitazi me vlerësimin e fakteve edhe interpretimin e ligjit, në dëm të parashtruesve të kërkesës. Në rrethana të tilla, duke marrë parasysh dispozitat ligjore, Gjykata nuk mund të konstatojë se mungesa e një seance dëgjimore në Kolegj të Apelit është e justifikuar vetëm si rezultat i mungesës së një kërkese nga palët në procedurë, posaçërisht marrë parasysh faktin që parashtruesit e kërkesës nuk janë ankuar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, i cili ishte në favor të tyre. Siç është sqaruar më lart, bazuar në nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në dhe neni 69 të Ligjit Nr. 06/L-086 për DHPGJS-në, është detyrim i Kolegjit të Apelit që edhe me nismën e tij të vlerësojë nëse mbajtja e një seancë dëgjimore është e detyrueshme, dhe nëse jo, të arsyetojë mos-mbajtjen e së njëjtës.

66. Së dyti, përkitazi me rrethanat e një rasti, Gjykata rikujton që praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, thekson se mungesa e një kërkese për një seancë dëgjimore, dhe vlerësimi nëse ky fakt mund të rezultojë në konstatimin se pala përkatëse në mënyrë të nënkuptuar ka hequr dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore, duhet të vlerësohet në tërësinë e specifikave të një procedure, dhe jo si argument i vetëm, për të konstatuar nëse mungesa e një seance dëgjimore ka rezultuar ose jo në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

67. Më specifkisht, në rastet kur një palë përkatëse nuk ka bërë një kërkesë për seancë dëgjimore, GJEDNJ ka vlerësuar nëse mungesa e një kërkese të tillë mund të konsiderohet sikur heqje dorë e nënkuptuar

nga një seancë dëgjimore, gjithmonë në dritën e ligjit të aplikueshëm dhe rrethanave të një rasti. Për shembull (i) në rastin *Miller kundër Suedisë* (Aktgjykim i 6 majit 2005), në të cilin, parashtruesja përkatëse nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të apelit, por e njëjta kishte kërkuar mbajtjen e një seancë dëgjimore në nivel të shkallës së parë, kishte rezultuar në konstatimin e GJEDNJ-së që kërkesa për seancë dëgjimore ishte bërë në fazën "*më të duhur e procedurave*" dhe për pasojë, GJEDNJ kishte theksuar se nuk mund të konstatohet se pala ka hequr dorë nga kërkesa për seancë dëgjimore në mënyrë të nënkuptuar. Për më tepër, në kombinim me konstatimin se në nivel apeli ishin shqyrtuar edhe çështje fakti edhe ligji, dhe për pasojë natyra e çështjeve në shqyrtim nuk ishte ekskluzivisht ligjore e as teknike, GJEDNJ, konstatoi se nuk ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore, duke konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miller kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafët 28-37); gjithashtu (ii) në rastin *Salomonsson kundër Zvicrës* (Aktgjykim i 12 shkurtit 2003), në të cilin, parashtruesi përkatës nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore në asnjërën nga instancat, GJEDNJ edhe pse konstatoi se parashtruesi përkatës mund të konsiderohet se ka hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga e drejta në një seancë dëgjimore (shih paragrafin 35 të rastit *Salomonsson kundër Zvicrës*), megjithatë konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore, sepse konkludoi që në rrethanat e rastit konkret, nuk ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore, posaçërisht marrë parasysh faktin që niveli i apelit shqyrtoi edhe çështje fakti dhe jo vetëm ligji (shih rastin e GJEDNJ-së *Salomonsson kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafët 36-40).

68. Në anën tjetër, në rastin *Goç kundër Turqisë*, GJEDNJ gjithashtu konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, duke refuzuar pretendimet e Qeverisë Turke se (i) rasti ishte i thjeshtë dhe se mund të trajtohej me shpejtësi vetëm në bazë të shkresave të lëndës, veçanërisht për shkak se parashtruesi përkatës përmes ankesës nuk kërkoi sjelljen e ndonjë prove të re; dhe se (ii) parashtruesi përkatës nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore (për faktet e rastit, shih paragrafët 11 deri 26 të rastit të GJEDNJ-së *Goç kundër Turqisë*). Në shqyrtimin e rastit përkatës, dhe pas vlerësimit nëse në rrethanat e tij ekzistonte ndonjë rrethanë e jashtëzakonshme që do të justifikonte mungesën e një seance dëgjimore, GJEDNJ konstatoi shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, duke theksuar, ndër të tjerash, se (i) përkundër faktit që parashtruesi përkatës nuk kishte bërë kërkesë për një seancë dëgjimore, nga rrethanat e rastit nuk rezulton se një kërkesë e tillë do

të kishte ndonjë perspektivë suksesi; për më tepër që (ii) nuk mund të konsiderohet se parashtruesi përkatës ka hequr dorë nga e drejta e tij për një seancë dëgjimore duke mos kërkuar një të tillë para gjykatës së apelit pasi që kjo e fundit nuk kishte juridiksion të plotë për të përcaktuar shumën e kompensimit; (iii) parashtruesit përkatës nuk i ishte dhënë mundësia të dëgjohet as para shkallës më të ulët dhe e cila kishte kompetencë edhe për vlerësimin e fakteve edhe të ligjit; dhe (iv) çështja thelbësore, në rrethanat e këtij rasti, ishte nëse parashtruesit përkatës duhet t'i ofrohej një seance dëgjimore para një gjykate e cila ishte përgjegjëse për vërtetimin e fakteve të rastit (për arsyetimin e rastit përkatës, shih paragrafët 43 deri 52 të rastit *Goç kundër Turqisë*).

69. Për dallim, në raste tjera, GJEDNJ ka konstatuar se fakti që një parashtrues nuk ka kërkuar një seancë dëgjimore mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar nga kjo e drejtë, mirëpo gjithmonë së bashku me vlerësimin nëse, në rrethanat e një rasti, ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat do ta justifikonin mungesën e një seancë dëgjimore. Për shembull, në rastet *Schuler-Zgraggen kundër Zvicrës* (Aktgjykim i 24 qershorit 1993) dhe *Dory kundër Suedisë* (Aktgjykim i 12 shkurtit 2003), në të cilat, parashtruesit përkatës nuk kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore, GJEDNJ kishte vlerësuar se të njëjtit kishin hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga e drejta për një seancë dëgjimore. Megjithatë, këtë konstatim GJEDNJ e kishte arritur, vetëm në ndërlidhje me konstatimin se rrethanat e rastit përkatës ishin të "*natyrës teknike*", dhe rrjedhimisht ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që e justifikojnë mungesës e një seance dëgjimore, duke mos konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miller kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafët 28-37; *Dory kundër Suedisë,* cituar më lart, paragrafët 36-45). Ngjashëm, GJEDNJ kishte vepruar edhe në rastin *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës* (Aktgjykimi i 19 prillit 2007), në të cilin nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (për arsyetimet përkitazi me seancën dëgjimore, shih paragrafët 73 deri 75 në rastin *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës*).

70. Gjykata gjithashtu bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, thekson se fakti që para gjykatave përkatëse ka mbizotëruar praktikë e zhvillimit të procedurës më shkrim dhe pa seanca dëgjimore, nuk është marrë parasysh nga GJEDNJ si fakt i vetëm bazuar në të cilin mund të anashkalohet një seancë dëgjimore, pa marrë parasysh rrethanat specifike të një rasti. Për shembull, në rastin *Madamus kundër Gjermanisë* (Aktgjykim i 9 qershorit 2016), GJEDNJ kishte shqyrtuar edhe pretendime bazuar në të cilat, ligji i aplikueshëm

parashihte mbajtjen e seancave dëgjimore si përjashtim dhe jo si rregull, për më tepër që bazuar në praktikën përkatëse, gjykata vendimi i së cilës kontestohej para GJEDNJ-së, asnjëherë nuk kishte mbajtur një seancë dëgjimore. Përkundër këtij fakti, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, pasi vlerësoi dhe konstatoi që në rrethanat e këtij rasti nuk ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e mbajtjes së një seancë dëgjimore (shih paragrafët 25 deri më 33 të rastit *Madamus kundër Gjermanisë*).

71. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, (i) parashtruesve të kërkesës nuk iu është dhënë mundësi të dëgjohen para Kolegjit të Specializuar, me kompetencë për vlerësimin e fakteve dhe të ligjit, përkundër kërkesës së tyre; (ii) parashtruesit e kërkesës nuk ishin ankuar në Kolegjin e Apelit sepse vendimi i Kolegjit të Specializuar ishte në favor të tyre; (iii) procedura në Kolegjin i Apelit ishte iniciuar përmes ankesës së AKP-së; (iv) Kolegji i Apelit, kishte *"hequr dorë nga seanca"*, duke u referuar në nenin 69 të Ligjit 06/L-086 për DHPGJS-në, nen ky identik me nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, të cilët thjeshtë përcaktojnë se "*Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse*"; dhe (v) Kolegji i Apelit, kishte shqyrtuar të gjitha faktet e rastit, duke përshirë ankesat e parashtruesve të dorëzuara në shkallë të parë, dhe duke theksuar se nuk pajtohet as me vlerësimin e fakteve dhe as me interpretimin e ligjit nga gjykata e shkallës më të ulët, kishte ndryshuar në tërësi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, duke i hequr të gjithë parashtruesit e kërkesës nga Lista e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar nga njëzet përqindëshi (20%-it) i privatizimit të ndërmarrjes NSH "Agimi".

72. Në rrethana të tilla, Gjykata nuk mund të konstatojë se mungesa e kërkesës së parashtruesve të kërkesës për mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar e tyre nga e drejta për një seancë dëgjimore. Gjykata rikujton se në të gjitha rastet në të cilat GJEDNJ kishte arritur në një konstatim të tillë, e kishte bërë në ndërlidhje me faktin se rrethanat e rasteve ndërlidheshin me çështje të natyrës ekskluzivisht ligjore ose të natyrës teknike, dhe rrjedhimisht "*ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seancë dëgjimore*". Për pasojë dhe në vijim, Gjykata duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, "*ekzistojnë rrethanat të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*", përkatësisht nëse natyra e çështjeve në vlerësim para

Kolegjit të Apelit, mund të klasifikohet si "*ekskluzivisht ligjore apo e natyrës së lartë teknike*".

d) Nëse në rrethanat e rastit konkret ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e seancës dëgjimore

73. Gjykata edhe një herë rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, palët kanë të drejtë në seancë dëgjimore në të paktën njërën instancë. Kjo instancë, është kryesisht instanca e parë, dhe ajo e cila e ka juridiksionin për të vendosur edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji. Në këtë kontekst, përkitazi me detyrimin për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë. Në parim, nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallën e parë, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore. Thënë këtë, përjashtim nga e drejta për një seancë dëgjimore, janë vetëm ato raste, në të cilat përcaktohet se "*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*". Këto rrethana, siç është sqaruar më lart, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së i ka klasifikuar si raste të cilat ndërlidhen me "*çështje ekskluzivisht ligjore apo të natyrës së lartë teknike*".

74. Për shembull, çështjet që ndërlidhen me sigurime sociale, GJEDNJ, kryesisht, i ka klasifikuar si çështje të natyrës teknike, në të cilat, jo detyrimisht është e domosdoshme një seancë dëgjimore. Sigurisht, nga ky rregull ka përjashtime. Në çdo rast, shqyrtohen rrethanat konkrete të një rasti. Për shembull, GJEDNJ nuk kishte konstatuar shkelje në rastet *Schuler-Zgraggen kundër Zvicrës* dhe *Dory kundër Suedisë*, por kishte konstatuar shkelje në rastin *Miller kundër Suedisë* dhe *Salomonsson kundër Zvicrës*, edhe pse të gjitha ndërlidheshin me çështje të sigurimeve sociale.

75. Në mënyrë të ngjashme, GJEDNJ vepron edhe në ato raste në të cilat çështjet para Gjykatës përkatëse janë ekskluzivisht ligjore, dhe nuk përfshijnë vlerësimin e fakteve kontestuese. Për shembull, në rastin *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore, pasi konstatoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin çështje fakti, por vetëm çështje

të limituar të natyrës ligjore (*Saccoccia kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 78), ndërsa në rastin *Allan Jacobsson kundër Suedisë* (no. 2) (Aktgjykim i 19 shkurtit 1998), gjithashtu GJEDNJ nuk konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore, pasi konstatoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin as çështje ligji e as fakti (shih rastin e GJEDNJ-së, *Allan Jacobsson kundër Suedisë (no. 2)*, cituar më lart, paragrafi 49).

76. Përkundrazi në raste të tjera e në të cilat, GJEDNJ përcaktoi se çështjet para gjykatave përkatëse ngërthenin edhe çështje fakti edhe ligji, ajo nuk konstatoi se ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore. Për shembull, në rastet *Malhous kundër Republikës Çeke* (Aktgjykim i 12 korrikut 2001), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, pasi përcaktoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin vetëm çështje ligji por edhe fakti, përkatësisht vlerësimin nëse autoriteti më i ulët i kishte vlerësuar faktet në mënyrë të drejtë (shih rastin e GJEDNJ-së *Malhous kundër Republikës Çeke*, cituar më lart, paragrafi 60). Në të njëjtën mënyrë, në rastin *Koottummel kundër Austrisë* (Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për mungesë të një seance dëgjimore, sepse konstatoi së çështjet para saj nuk mund të kualifikoheshin si çështje të natyrës ekskluzivisht ligjore ose të natyrës teknike, që do të mund të konsistonin në rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Koottummel kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafët 20 dhe 21).

77. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht rikujton që Kolegji i Apelit, ka juridiksion edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji. Bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 (Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet) të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Ligji për DHPGJS-në) dhe paragrafin 4 të nenit 64 (Procedurat e ankesës me gojë) dhe nenin 65 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, palët, ndër tjerash, kanë mundësinë që të ngritin ankesa para Kolegjit të Apelit edhe përkitazi me çështjet e ligjit edhe të fakteve, duke përfshirë edhe mundësinë që të paraqiten prova të reja.

78. Për më tepër, në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar të gjitha faktet e paraqitura përmes ankesës së AKP-së në Kolegjin e Apelit dhe të përgjigjeve përkatëse në ankesë të parashtruesve të kërkesës. Përkundër faktit që Kolegji i Specializuar

kishte vlerësuar se provat *"janë të qarta"* duke u dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës, Kolegji i Apelit kishte konstatuar të kundërtën bazuar në po të njëjtat prova.

79. Gjykata gjithashtu rikujton që bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 të Ligjit për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit është i kufizuar në ndërrimin e vlerësimit të gjendjes faktike të bërë nga Kolegji i Specializuar, përpos nëse përcakton që gjetjet faktike të gjykatës më të ultë janë "*qartësisht të gabueshme*", rregull ky që sipas të njëjtit nen duhet të "*respektohet fuqimisht*". Një arsyetim i tillë, nuk gjendet në Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit. Ky i fundit, thjesht nuk ishte pajtuar më vlerësimin e provave nga Kolegji i Specializuar, dhe gjithashtu kishte konstatuar se interpretimi të cilin Kolegji i Specializuar ia ka bërë pretendimeve përkitazi me diskriminim, është në kundërshtim me *"të drejtën precedentale"*.

80. Gjykata më tej vëren, se bazuar në nenin 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, në rast të ankesave lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, barra e provës bie mbi parashtruesit e kërkesës përkatëse para Kolegjit të Specializuar. Po ashtu, barra e të provuarit për kundërshtuesin e një kërkesë të tillë, bie mbi kundërshtuesin, përkatësisht AKP-në, në rrethanat e rastit konkret. Para Kolegjit të Apelit, barra e të provuarit gjithashtu bie mbi parashtruesin e ankesës përkatëse. Por, rrethanat e rastit konkret, gjithashtu, në esencë ndërlidhen me pretendime për diskriminimin. Në rast të pretendimeve të tilla, barra e të provuarit, bazuar në nenin 8 (Barra e Provave) të Ligjit kundër Diskriminimit, bie mbi palën e paditur, përkatësisht AKP-në, dhe jo parashtruesit e kërkesës.

81. Në rrethana të tilla, në të cilat (i) Kolegji i Apelit ka shqyrtuar edhe çështje fakti edhe ligji; (ii) në të cilat përkitazi me faktet, barra e të provuarit se i plotësojnë kriteret e paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13, në parim bie mbi parashtruesit e kërkesës, ndërsa barra e të provuarit lidhur me diskriminimin bie mbi AKP-në; dhe (iii) Kolegji i Apelit interpreton të njëjtat fakte të paraqitura nga palët në mënyrë të ndryshme nga mënyra se si i ka interpretuar Kolegji i Specializuar, duke ndryshuar Aktgjykimin në dëm të palëve, përkundër faktit që një mundësi e tillë bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-033 për DHPGJS-në, i është njohur vetëm përjashtimit, me kushtin që të argumentojë që autoriteti më i ulët, përkatësisht Kolegji i Specializuar, ka bërë interpretim *"qartësisht të gabueshëm"*, Gjykata vlerëson se është e pakontestueshme që çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk është (i) as çështje ekskluzivisht ligjore; dhe (ii) as e natyrës teknike. Përkundrazi, çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit ngërthente çështje të rëndësishme

faktike dhe ligjore. Për pasojë, Gjykata duhet të konstatojë, se në rrethanat e rastit konkret, nuk ekzistojnë rrethana të cilat do e justifikonin mungesën e seancës dëgjimore.

82. Në mbështetje të këtij konstatimi, Gjykata rikujton që përmes Aktgjykimit të GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, specifikisht ishte përcaktuar se një seancë dëgjimore është e domosdoshme në rrethana që ngërthejnë nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë. Kjo vlen posaçërisht në rrethana në të cilat, një seancë dëgjimore nuk është mbajtur as para shkallës më të ulët, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret.

83. Në fakt, në disa raste GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së kur një seancë dëgjimore nuk ishte mbajtur në një gjykatë me juridiksion apeli, edhe atëherë kur një seancë dëgjimore ishte mbajtur në instancën më të ulët, përkundër faktit se vlerësimi i domosdoshmërisë së seancës dëgjimore në nivel apeli është më pak rigoroz atëherë kur një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallën e parë. Për shembull, në Aktgjykimin *Helmers kundër Suedisë*, GJEDNJ shqyrtoi një rast në të cilin parashtruesit përkatës i ishte mundësuar një seancë dëgjimore në shkallën e parë, por jo në nivelin e apelit, e cila kishte kompetencë të vlerësonte edhe ligjin edhe faktet në rrethanat e rastit përkatës. Në këtë rast, GJEDNJ kishte ritheksuar se (i) garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, jo detyrimisht garantojnë një seancë dëgjimore në nivel apeli, nëse një e tillë është mbajtur në shkallën e parë; dhe (ii) në marrjen e këtij vendimi, gjykata përkatëse duhet gjithashtu të ketë parasysh nevojën për trajtimin ekspeditiv të rasteve si dhe të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Megjithatë, duke vënë theks në faktin se një përcaktim i tillë varet nga natyra e çështjeve që ngërthen një rast dhe nevojë për ekzistimin e rrethanave të jashtëzakonshme në mënyrë që të justifikohet mungesa e një seance dëgjimore, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (për arsyetimin përkatës të rastit, shih paragrafët 31 deri 39 të rastit *Helmers kundër Suedisë*).

84. Në fund, Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se Kolegji i Apelit nuk kishte arsyetuar *"heqjen dorë nga seanca"*, por ishte mjaftuar vetëm me referimin në nenin 69 të Ligjit 06/L-086 për DHPGJS-në. Ky i fundit, siç është sqaruar më lart, thjesht përcakton kompetencën e Kolegjit të Apelit për të vendosur për mbajtjen e seancës dëgjimore bazuar në nismën e tij ose me kërkesë të palës. Aktgjykimi përkatës nuk përmban asnjë sqarim shtesë lidhur me vendimin e Kolegjit të Apelit për të *"hequr dorë nga seanca"*. Në këtë kontekst, Gjykata

thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me mungesën e një seance dëgjimore, duhet të shqyrtohet edhe nëse refuzimi i mbajtjes së një seance të tillë është i arsyetuar. Për shembull në rastin e GJEDNJ-së *Pönkä kundër Estonisë*, (Aktgjykimi i 8 nëntorit 2016), e që ndërlidhej me zhvillimin e një procedure të thjeshtuar (e rezervuar për padi të vogla), GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, sepse gjykata përkatëse nuk kishte arsyetuar mungesën e një seance dëgjimore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Pönkä kundër Estonisë*, cituar më lart, paragrafët 37-40). Gjithashtu, në rastin e GJEDNJ-së, *Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë*, cituar më lart, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, ndër të tjerash edhe pse gjykata përkatëse nuk kishte dhënë shpjegim për mosmbajtjen e një seance dëgjimore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë*, cituar më lart, paragrafi 44). Në kontekst të mungesës së arsyetimit të mosmbajtjes së një seance dëgjimore, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, në mënyrë të vazhdueshme, ndër të tjerash, ka theksuar se mungesa e arsyetimit rreth domosdoshmërisë së mbajtjes së një seance dëgjimore, i pamundëson gjykatës më të lartë, të vlerësojë nëse një mundësi e tillë thjeshtë është neglizhuar, apo cilat janë argumentet bazuar në të cilat gjykata ka anashkaluar një mundësi të tillë në raport me rrethanat që ngre një rast i caktuar (shih rastin e GJENDJ-së, *Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë,* paragrafi 44 dhe referencat e përdoruara aty).

85. Prandaj, dhe në përfundim, Gjykata, duke marrë parasysh që (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar shprehimisht mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton se të njëjtit në mënyrë të nënkuptuar kanë hequr dorë nga kjo e drejtë, posaçërisht duke marrë parasysh që të njëjtit nuk e kanë iniciuar ankesën para Kolegjit të Apelit dhe gjithashtu se mungesa e kësaj kërkese, nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi për vlerësimin e domosdoshmërisë së një seance dëgjimore; (ii) përkundër kërkesës specifike të parashtruesve përkatës për seancë dëgjimore para Kolegjit të Specializuar, një e tillë nuk ishte mbajtur dhe rrjedhimisht, standardet që aplikohen për domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit janë më rigoroze, sepse, në parim, palët kanë të drejtë në një seancë dëgjimore të paktën para një instance gjyqësore; (iii) çështjet në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk mund të kualifikohen as si çështje ekskluzivisht ligjore dhe as çështje të natyrës teknike, por përkundrazi si çështje të faktit dhe ligjit; (iv) Kolegji i Apelit kishte vlerësuar mënyrën se si instanca më e ultë, përkatësisht Kolegji i Specializuar kishte bërë vlerësimin e fakteve, duke e ndryshuar Aktgjykimin e tij në dëm të parashtruesve të kërkesës; dhe (v) Kolegji i Apelit nuk e kishte arsyetuar "*heqjen dorë*

nga seanca", konstaton se në rastin konkret nuk kanë "*ekzistuar rrethana të jashtëzakonshme për të justifikuar mungesën e një seance dëgjimore*", dhe për pasojë, Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

86. Gjykata, në fund gjithashtu thekson se, duke marrë parasysh që tashmë ka konstatuar që Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës. Pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Për më tepër, duke marrë parasysh që Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për të shqyrtuar vendimet e kontestuara të Kolegjit të Specializuar bazuar në ligjet e aplikueshme për DHPGJS-në, i njëjti ka mundësinë e korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë.

87. Konstatimi i Gjykatës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet ekskluzivisht me mungesën e seancës dëgjimore, siç është sqaruar në këtë Aktgjykim, dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me dhe as nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

Përfundimi

88. Gjykata, në rrethanat e këtij rasti, ka vlerësuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës, përkitazi me mungesën e seancës dëgjimore, e drejtë kjo e garantuar, sipas sqarimeve të këtij Aktgjykimi, përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenit 6 të KEDNJ-së.

89. Në vlerësimin e pretendimeve përkatëse, Gjykata fillimisht ka shtjelluar parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika e saj gjyqësore dhe ajo e GJEDNJ-së, përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore, duke i sqaruar rrethanat në të cilat një e tillë është e domosdoshme, bazuar ndër tjerash, në Aktgjykimin e Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*. Gjykata ka sqaruar, ndër tjerash, se (i) mungesa e kërkesës së një pale për seancë dëgjimore jo detyrimisht nënkupton heqjen dorë nga një e drejtë të tillë dhe se vlerësimi i ndikimit të mungesës së një kërkese të tillë varet nga specifikat e ligjit dhe rrethanat e veçanta të një rasti; dhe (ii) në parim, palët kanë të drejtë

në një seancë dëgjimore në të paktën në një nivel të juridiksionit, përpos nëse "*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*", e të cilat bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim ndërlidhen me raste në të cilat shqyrtohen "*çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike*".

90. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tyre nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që, me nismën e tij, të trajtojë domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore; (ii) parashtruesve të kërkesës iu është mohuar e drejta e seancës dëgjimore në të dy nivelet e DHPGJS-së; (iii) Kolegji i Apelit, nuk kishte trajtuar "*çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike*", çështje këto bazuar në të cilat do të mund të kishin ekzistuar "*rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*"; (iv) Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar çështje "*fakti dhe ligji*" për më tepër që, kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar në dëm të parashtruesve të kërkesës; dhe (v) Kolegji i Apelit, nuk kishte arsyetuar "*heqjen dorë nga seanca gojore*". Duke marrë parasysh këto rrethana dhe arsyetimet e tjera të dhëna në këtë Aktgjykim, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore.

91. Gjykata gjithashtu theksoi se (i) bazuar në ligjin e aplikueshëm për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për vlerësimin e vendimeve të Kolegjit të Specializuar dhe rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka mundësinë e korrigjimit të mungesës së seancës dëgjimore në nivelin e gjykatës më të ulët, përkatësisht, Kolegjit të Specializuar; (ii) nuk është e nevojshme të trajtohen pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës sepse të njëjtat duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit në përputhshmëri me konstatimet e këtij Aktgjykimi; dhe (iii) konstatimi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret ndërlidhet vetëm me garancitë procedurale për një seancë dëgjimore dhe në asnjë mënyrë nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

92. Gjykata po ashtu konstatoi se kërkesa e parashtruesve të kërkesës KI221/19 (Muhamet Domi) dhe KI234/19 (Fikrije Nuka) duhet të refuzohet qartazi e pabazuar siç specifikohet me rregullin 39 (2) të

Rregullores së punës, për shkak se nuk kanë ofruar ndonjë provë që ankesat e tyre janë përjashtuar nga procedura e vlerësimit në DHPGJS.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 mars 2021, me shumicë votash:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesat KI220/19 dhe KI223/19 të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se për kërkesat KI220/19 dhe KI223/19, ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme;

IV. TË KTHEJË çështjen në rivendosje në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi;

V. TË URDHËROJË Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës deri më 14 qershor 2021;

VI. TË DEKLAROJË të papranueshme kërkesat me nr. KI221/19 dhe KI234/19 të dorëzuara nga parashtruesit Muhamet Domi dhe Fikrije Nuka;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI87/20, Parashtruesi i kërkesës: Suva Rechtsabteilung, Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktvendimit [E.Rev.nr.68/2019] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 27 janarit 2020

KI87/20, Aktvendim për papranueshmëri, i miratuar më 26 mars 2021, publikuar më 13 prill 2021

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, arsyetim i vendimit gjyqësor, divergjencë në praktikën gjyqësore, kërkesë qartazi e pabazuar, kërkesë e papranueshme.*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një aksidenti të ndodhur në vitin 2012, i cili ishte shkaktuar nga i siguruari i Kompanisë "Siguria", ndërsa i siguruari i parashtruesit të kërkesës B.I., kishte pësuar dëme materiale. Parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar padi pranë Gjykatës Themelore më 8 dhjetor 2015 për kompensim të dëmit material në kuadër të drejtës së tij për subrogim. Kërkesa për kompensim të dëmit material ishte aprovuar nga Gjykata Themelore, dhe ishte caktuar kamatëvonesa në lartësi prej 12% duke filluar nga 20 shtatori 2013 deri në pagesën definitive. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ae.nr.130/2018], të 3 shtatorit 2019 aprovoi pjesërisht ankesën e Kompanisë "Siguria" dhe Aktgjykimin [III.Ek.nr. 561/2015] e 5 prillit 2018 të Gjykatës Themelore e ndryshoi vetëm sa i përket pjesës përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës, duke e detyruar Kompaninë "Siguria" që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë kamatëvonesën sipas normës vjetore prej 8 % në vit, duke konstatuar se Gjykata Themelore në këtë pikë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, respektivisht neni 26, paragrafi 6 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nuk është i aplikueshëm në rastet e kërkesave në bazë të të drejtës për subrogim, por në këtë rast është i aplikueshëm neni 382 i LMD-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, duke e kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit vetëm sa i përket pjesës së vendimit të saj përkitazi me kamatëvonesën. Në këtë rast, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit [E.Rev.nr.28/2019] të 27 janarit 2020 revizionin e parashtruesit të kërkesës e hodhi poshtë si të palejuar me arsyetimin se në bazë të nenit 30 paragrafit 2 të LPK-së, kamatëvonesa si kërkesë akcesore nuk merret parasysh nëse nuk përbën kërkesën kryesore, e cila në këtë rast është kërkesa për kompensim në bazë të të drejtës për subrogim.

Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e lartcekura të Gjykatës Supreme, duke pretenduar (i) shkelje të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata rikujton se në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi pretendon: (i) mosarsyetim të vendimit gjyqësor; (ii) mohim të së drejtës së tij për qasje në gjykatë; dhe (iii) divergjencë në praktikën gjyqësore, si

rezultat i vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme; dhe (ii) shkelje të së drejtës së tij në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, ne lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar edhe standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konstatoi se kërkesa është e papranueshme, sepse, pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe nenit 46 të Kushtetutës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese ashtu siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI87/20

Parashtrues

"SUVA" Rechtsabteilung

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit E. Rev. nr. 68/2019 të Gjykatës Supreme, të 27 janarit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga kompania e sigurimeve "SUVA Rechtsabteilung" me seli në Lucern të Zvicrës, e përfaqësuar nga ICS Assistance LLC, përmes Visar Morina dhe Besnik Z. Nikqi, avokat në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [E.Rev.nr.68/2019] të 27 janarit 2020 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme). Parashtruesi i kërkesës Aktvendimin e kontestuar e ka pranuar më 10 shkurt 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 8 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 qershor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepin Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 17 qershor 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për çështje ekonomike (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) kërkesën që të dorëzojë fletëkthesën e cila dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

8. Më 3 korrik 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi fletëkthesën e kërkuar, e cila tregon që parashtruesi i kërkesës Aktvendimin e kontestuar e ka pranuar më 10 shkurt 2020.

9. Më 26 mars 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Bazuar në shkresat e lëndës, më 25 dhjetor 2012, personi B.I. i cili ishte i siguruar tek parashtruesi i kërkesës, kishte pësuar aksident komunikacioni të shkaktuar nga një i siguruar i Kompanisë "Siguria" në Prishtinë. I siguruari i parashtruesit të kërkesës kishte marrë trajtime mjekësore për një periudhë të caktuar në Konfederatën e Zvicrës, të cilat ishin paguar nga parashtruesi i kërkesës

11. Më 20 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës kishte iniciuar kërkesë për regresim borxhi në procedurë jashtëgjyqësore. Sipas shkresave të lëndës, si rezultat i mosarritjes së marrëveshjes jashtëgjyqësore për dëmshpërblim në procedurë jashtëgjyqësore, rezulton se më 8 dhjetor 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në bazë të së drejtës në subrogim pranë Gjykatës Themelore.

12. Më 5 prill 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [III.Ek.nr. 561/2015]:

    (i) aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) detyroi Kompaninë "Siguria" që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë shumën e kompensimit prej 69,371.63 euro, së bashku me kamatëvonesën prej 12% në vit duke filluar nga 20 shtatori 2013 deri në pagesën definitive; dhe (iii) detyroi Kompaninë "Siguria" të paguante edhe shpenzimet e procedurës.

13. Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit të saj, përcaktimin e kamatëvonesës prej 12% e arsyetoi duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit Nr. 04/L-018 mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm).

14. Në një datë të paspecifikuar, Kompania "Siguria" parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozimin që Aktgjykimi i atakuar të refuzohet si i pabazuar. Parashtruesi i kërkesës parashtroi përgjigje në ankesë dhe propozoi që ankesa e Kompanisë "Siguria" të shpallet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi [III.Ek.nr. 561/2015] i 5 prillit 2018, i Gjykatës Themelore.

15. Më 3 shtator 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ae.nr.130/2018] aprovoi pjesërisht ankesën e Kompanisë "Siguria" dhe Aktgjykimin [III.Ek.nr. 561/2015] e 5 prillit 2018 të Gjykatës Themelore e ndryshoi vetëm sa i përket pjesës përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës, duke e detyruar Kompaninë "Siguria" që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë kamatëvonesën sipas normës vjetore prej 8 % në vit.

16. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata e Apelit konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore sa i përket pjesës përkitazi me kamatëvonesën është i përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Gjykata e Apelit konstatoi se *"[...] kamata e aprovuar nga gjykata e shkallës së parë, ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për regresim borxhi por vetëm në kërkesat e trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblim të dëmit në procedurë jashtëgjyqësore ashtu siç parashihet me nenin 26 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, në të cilat dispozita thirret gjykata e shkallës së parë. [...] Paragrafi 7, i nenit 26 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësi, përjashton zbatimin e kamatës prej 12% për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënien në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim. Nga kjo rezulton se paditësi ka të drejtë vetëm në kamatëvonesë të paraparë me nenin 382 të LMD-së [Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve], por jo edhe kamatë të kualifikuar sipas dispozitave të zbatuara nga gjykata e shkallës së parë".*

17. Më 30 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion kundër Aktgjykimit [Ae.nr.130/2018] të 3 shtatorit 2018, të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që në rastin konkret duhet aplikuar neni 26, paragrafi 6 i Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm, përkatësisht të zbatohet norma vjetore e kamatëvonesës në lartësi prej 12%.

18. Më 27 janar 2020, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [E.Rev.nr.28/2019] revizionin e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit [Ae.nr.130/2018] të 3 shtatorit, të Gjykatës së Apelit e hodhi poshtë si të palejuar.

19. Në lidhje me konstatimin e saj, Gjykata Supreme arsyetoi se:

> *"Nga revizioni i të autorizuarit të paditësit, rezulton se Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është goditur vetëm përkitazi me vendimin lidhur me kamatën e gjykuar. Në kuptim*

të nenit 30.2 të LPK [Ligjit për Procedurën Kontestimore], kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera akcesore, nuk merren parasysh në çoftë se nuk përbëjnë kërkesën kryesore, ku në rastin konkret kërkesa kryesore është regresim i borxhit në shumë prej 69.371, 63 €, ndërsa kamata është akcesore, kështu që në kuptim të par. 1 të këtij neni si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore. Në nenin 211. 2 të LPK, parashihet që revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, poqë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 €. Së këndejmi revizioni i të autorizuarit të paditësit nuk është i lejuar."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [E.Rev.nr.28/2019] i 27 janarit 2020 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

I. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

21. Parashtruesi i kërkesës, pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i shkeljes të së drejtës në (i) vendim të arsyetuar gjyqësor; (ii) qasjes në gjykatë; dhe (iii) jokonsistencës apo divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme.

(i) Përkitazi me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor

22. Parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, *"[...] është pa mbështetje në dispozitë konkrete juridike, e cila në mënyrë eksplicite do të përjashtonte mundësinë e procedimit të kërkesëpadisë lidhur me kamatëvonesën me revizion ç'është e vërteta, Ligji për Procedurën Kontestimore nuk përmban një dispozite të tillë (ku shprehimisht nuk lejohet revizioni përkitazi me kamatëvonesën), por kufizimi për Lejueshmërinë ose jo të revizionit mbështetet në vlerën e kontesteve pasurore juridike".*

23. Parashtruesi i kërkesës, në vijim po ashtu specifikon se: *"[...] kufizimi për Lejueshmërinë ose jo te revizionit mbështetet në vlerën e kontesteve pasurore juridike. Përndryshe, ne rastin konkret, kërkesa pasurore juridike ka të bëjë me "konteste tregtare" (përkitazi me të cilat lejohet revizioni në kontestet me vlerë mbi 10,000.00 Euro / Neni 508 i LPK) e jo siç; është theksuar ne arsyetimin e Aktvendimit te Gjykatës Supreme shuma prej 3,000.00 Euro (për çfarë rezulton se Gjykata Supreme nuk i është referuar drejte dispozitës respektive përkitazi me vlerën e kontestit ne rastin konkret si "kontest tregtar")".*

24. Ndërsa parashtruesi i kërkesës ka elaboruar parimet themelore të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor siç është e garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe në mbështetje të këtyre argumenteve, parashtruesi i kërkesës i është referuar edhe rasteve të Gjykatës KI35/18, parashtrues *Bayerische Rechstverbrand*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019; KI87/18, parashtrues *IF Skadeforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, KI72/12, parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykim, i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim, i 9 qershorit 2017; KI97/16 parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017; KI143/15, parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018; KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu,* Aktgjykim, i 27 majit 2019, si dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) *Hadjianastassou kundër Greqisë*, Aktgjykim, i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim, i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim, i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim, i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim, i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim, i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim, i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvilli kundër Rusisë*, Aktgjykim, i 22 shkurtit 2007.

25. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme i mungon arsyetimi adekuat për arsye se në mënyrë të gabuar është interpretuar paragrafi 2 i nenit 30 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK). Për pasojë, sipas parashtruesit të kërkesës atij i është mohuar e drejta e shqyrtimit kryesor të kërkesëpadisë së tij në tërësi, përkatësisht i është pamundësuar *"[...] që me revizion të trajtohet pretendimi për zbatim të gabuar të drejtës materiale në pjesën e kërkesëpadisë që i referohet kamatëvonesës".*

26. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës specifikon se *"[...] neni 30 i LPK-së është vetëm në funksion të përcaktimit të vlerës se objektit të kontestit në përgjithësi, por në asnjë mënyrë në rastet kur kërkesëpadia lidhur me kamatën është objekt i vetëm (i pavarur) i shqyrtimit gjyqësor (si ne rastin konkret me revizionin)".*

27. Parashtruesi i kërkesës vazhdon duke nënvizuar se *"Në të kundërtën, një qëndrim respektivisht interpretim i tillë gramatikor i dispozitës së nenit 30.2 të LPK nga Gjykata Supreme e Kosovës rezulton jo logjik me konkluzion se kontesti lidhur me kërkesëpadinë për kamatat është pavlerë fare."* Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës i referohet padisë së 8 dhjetorit 2015, ku sipas tij *"[...] kamatëvonesa ishte përfshirë në kërkesëpadi së bashku me kërkesën për subrogim çfarë njëkohësisht është trajtuar si e tillë edhe me aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta".*

28. Parashtruesi i kërkesës, në vijim nënvizon se arsyetimi i tij *"[...] mbështetet në konceptin e mirënjohur të së drejtës civile se "kamata ndan fatin e njëjtë të detyrimit kryesor", andaj mohimi i të drejtës ne shqyrtim gjyqësor me revizion ne rastin konkret del te jetë në kundërshtim me këtë koncept dhe si i tillë do të rezultonte përfundimi se kërkesëpadia për kamatëvonesën nuk mund të jetë objekt shqyrtimi me revizion respektivisht në një proces gjyqësor".*

29. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës rithekson se "*Gjykata ka dështuar të ofroj një arsyetim adekuat te vendimit, të interpretojë dhe zbatojë drejtë nenin 30 të LPK-së në çështjen kontestuese, argumentohet edhe në aspekt doktrinar. Sipas Komentarit te Ligjit te Procedurës Civile (Iset Morina dhe Selim Nikqi, "Komentar-Ligji për procedurën kontestimore." (2012). "dispozita e par. 2 të Nenit 30 të LPK përcakton shprehimisht se kërkesat e tjera aksesore (kamata) nuk duhet të llogariten për caktimin e vlerës së objektit te kontestit".* Ky përkufizim përkitazi me përcaktimin e vlerës se kontestit është rrjedhoje logjike e zbatimit te principit se "kërkesat aksesore (kamata) ndajnë fatin e kërkesës kryesore"." Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës ripërsëritë se " *[...] kamatat nuk merren parasysh për caktimin e vlerës së objektit të kontestit, përveç në rastin kur kamata është objekt i vetëm i kërkesëpadisë." Në kontekst të kësaj të fundit, parashtrues i kërkesës thekson se: "[...] për kërkesëpadinë përkitazi me kamatën si objekt i revizionit respektivisht si kërkesë e pavarur në shqyrtim gjyqësor, merret në konsideratë shuma e saj për përcaktimin e vlerës se kontestit - kjo në kuptim te dispozitës se Nenit 30.1 dhe 30.2 të LPK. Përndryshe, një qëndrim dhe interpretim ndryshe i kësaj dispozite, rezulton me konkluzionin se kërkesëpadia për kamatëvonesën është e pa vlere dhe si e tille pamundëson*

trajtimin e çështjes me revizion - si të pa lejuar, siç ka vendosur Gjykata Supreme me Aktvendimin e kontestuar".

30. Në kontekst të asaj që u theksua më lart, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore dhe asaj kushtetuese të rajonit, duke theksuar se *"[...] kamatëvonesa mund të jetë i vetëm shqyrtimi me revizion duke përfshirë praktikën përkatëse për mënyrën e përllogaritjes së vlerës së kontestit ku kamatëvonesa është objekt i vetëm i revizionit."* Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës i referohet një prezantimit të *"Dr. Ivo Grbin: Vrhovni Sud Hrvatske II Rev 65/00 dt. 30.09.2003 Stav. Ustavnog Suda RH Odluka Br. U-III-2646/2007 & Delimicno BiH: Vrhovni Sud BiH Br. 57 0 PS 004906 16 rev 2 dt. 11.08.2016".*

31. Parashtruesi i kërkesës përsëritë se "*Gjykata Supreme e Kosovës me këtë ka pamundësuar të shqyrtohen pretendimet e paditësit për kontestin tregtar, respektivisht për shqyrtimin e pretendimit mbi mënyrën e llogaritjes se kamatëvonesës ne çështjen konkrete dhe zbatimin e normës vjetore 12 % ne vend te 8 % sa është përcaktuar me vendimin e Gjykatës se Apelit. Nga shkresat e lëndës vërehet në mënyrë të qartë se vlera e kërkesëpadisë kontestuese për kamate, qe ishte objekt i revizionit (dallimi në mes të normës vjetore 8% dhe 12%) është në vlerë prej 16,956.45 Euro. Andaj vendimi i Gjykatës Supreme për mos-lejimin e Revizionit te Parashtruesit bazuar ne kriterin e lartësisë se kërkesëpadisë sipas Ligjit te Procedurës Kontestimore qartazi tregon se arsyetimi i vendimit te Gjykatës Supreme jo vetëm se është i mangët por përbën edhe interpretim te gabuar te legjislacionit ne fuqi".*

32. Në fund dhe në kontekst të mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës thekson se *"Mungesa e arsyetimit te vendimit te kontestuar dëshmohet edhe me faktin se ne pjesën e arsyetimit Gjykata Supreme as qe ka saktësuar lartësinë e vlerës se kërkesëpadisë ne relacion me kërkesën aksesore, pra te kamatëvonesës. Për Gjykatën Supreme ka mjaftuar arsyetimi i Aktvendimit vetëm me një paragraf te shkurtër se "ne rastin konkret kërkesa kryesore është regresimi i borxhit ne shume prej 69.371.63 euro ndërsa kamata është kërkesë aksesore kështu qe ne kuptim te para. 1 te këtij neni si vlere e objektit te kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore", pa dhënë as edhe një shpjegim te mëtejmë se sa është vlera monetare e kërkesës aksesore ne këtë rast gjyqësor dhe nëse një vendim i tille është ne kundërshtim me parimin e mirënjohur ne te drejtën civile se "kamata ndan fatin e njëjte te detyrimit kryesor".*

(ii) Përkitazi me pretendimin për mohimin e të drejtës për qasje në gjykatë

33. Parashtruesi i kërkesës thekson se përmes Aktvendimit të Gjykatës Supreme i është mohuar e drejta e qasjes së tij në gjykatë dhe e drejta për tu dëgjuar.

34. Parashtruesi i kërkesës specifikon se: *"Meqë Parashtruesi ka shfrytëzuar të gjitha mjetet e rregullta juridike për të realizuar të drejtën e zhdëmtimit me kërkesën për subrogim në shkallë të parë dhe shkallë të dytë, një vendim i këtillë i Gjykatës Supreme me mangësi serioze në pjesën e arsyetimit përbën mohim të qasjes në drejtësi dhe përbën mos administrim të mirëfilltë të drejtësisë në rastin konkret"*.

(iii) Përkitazi me pretendimin për divergjencë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme

35. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës sqaron se *"[...] ka me dhjetëra raste të Gjykatës Supreme të Kosovës që në procedurën e revizionit është vendosur përkitazi me pretendimet për zbatimin e gabuar të drejtës materiale lidhur me kamatëvonesën respektivisht se në rastin konkret zbatohet kamatëvonesa prej 12% ne vit (sipas "lex specialis") [...]"* dhe për pasojë sipas parashtruesit të kërkesës, në mungesë të shqyrtimit të revizionit të tij nga ana e Gjykatës Supreme mbetet në fuqi Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit *"[...] me zbatim të gabuar të drejtës materiale (norme vjetore te interesit 8%) që është në kundërshtim me praktikën e Gjykatës Supreme të Kosovës"*. Në kontekst të kësaj të fundit parashtruesi i kërkesës i referohet dhe ka dorëzuar Aktgjykimet e Gjykatës Supreme, respektivisht Aktvendimin [E. Rev. 43/2014] të 22 shtatorit 2014; dhe Aktgjykimet [E. Rev. 25/2014, të 13 majit 2014; [E. Rev. 23/2017] të 14 dhjetorit 2017; dhe [E. Rev. 27/2018] të 24 shtatorit 2018. Në vijim, parashtruesi i kërkesës po ashtu ka dorëzuar një Aktgjykim [C. nr. 745/2013] të 28 shtatorit 2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe Aktgjykimin [Ae.nr. 247/2016] të 6 qershorit 2018, të Gjykatës së Apelit.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

36. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se *"[...] dështimi i Gjykatës Supreme të Kosovës për të dhënë vendime te arsyetuara (dhe në rastin konkret refuzimi arbitrar i revizionit të parashtruar)"* nga ai,

ka cenuar edhe të drejtën e pronës të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

37. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës thekson *"[...] se ka pasur pritje legjitime që do të gëzojë dëmshpërblim në shumën e lartpërmendur sipas të drejtës në subrogim që do të thotë të drejtën në rimbursim të dëmit të shkaktuar nga personi përgjegjës apo siguruesi i tij i përgjegjësisë mbi bazën e kamatës vjetore të përcaktuar me ligj."* Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të Gjykatës KI58/09, KI59/09, KI60/09, KI64/09, KI66/09, KI69/09, KI70/09, KI72/09, KI75/09, KI76/09, KI77/09, KI78/09, KI79/09, KI03/10, KI05/10, KI13/10, *Gani Prokshi dhe 15 ish-punëtorë të tjerët të Korporatës Energjetike të Kosovës*, Aktgjykim, i 18 tetorit 2010, paragrafi 59 përmes të cilës ka theksuar se: *"[...] një pritje e tille legjitime garantohet me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, natyra e saj është konkrete, dhe jo vetëm një shpresë e thjeshtë"*.

38. Në vijim, parashtruesi i kërkesës specifikoi se "*kjo pritshmëri legjitime e [tij] mbështetet në Sistemin e Sigurimit te Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë (Neni 2, par 4 i BQK Rregulli Nr. 3 mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë – 2008 [...]"*. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe rastit të Gjykatës KI40/09, parashtrues *Imer Ibrahimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerët të Korporatës Energjetike të Kosovës*, Aktgjykim, i 23 qershorit 2010, dhe rastit të GJEDNJ-së *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, kërkesa nr. 39794/98, Vendim për pranueshmëri, i 10 korrikut 2002.

39. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës përfundon se mohimi i së drejtës së tij *"[...] në subrogim dhe në pagesën e kamatëvonesës sipas legjislacionit ne fuqi si pasoje e një vendimi te paarsyetuar përbën qarte ndërhyrje ne gëzimin e se drejtës se pronës në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe te nenit 1 te Protokollit 1 te Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

40. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesën e tij: ta shpallë të pranueshme; të konstatojë që Aktvendimi i kontestuar [E. Rev. nr.68/2019] i 27 janarit 2020, i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; si dhe Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme ta shpallë të pavlefshëm, duke e kthyer çështjen në rivendosje.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

2. *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të*

natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Protokoll shtesë i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

NENI 1
Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cënojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

4. Përcaktimi i vlerës së objektit të kontestit

Neni 30

30.1 Paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi ta përcaktoj vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore.
30.2 Kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera akcesore, nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbëjnë kërkesë kryesore.

KREU XIV MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES REVIZIONI

Neni 211

211.1 Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi.
211.2 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro.
211.3 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro.
211.4 Përjashtimisht edhe kur është fjala për kërkesëpadinë nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, revizioni gjithmonë është i lejuar:
a) në kontestet për ushqim;
b) në kontestet për shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur, për shkak të vdekjes së dhënësit të ushqimit;

c) në kontestet nga marrëdhëniet e punës të cilat i fillon i punësuari kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës.

Neni 508

Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10.000 Euro.

LIGJI 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE [i publikuar në Gazetën Zyrtare më 19 qershor 2012. Sipas nenit 1059 të Ligjit, Ligji ka hyrë në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare]

Neni 281
Subrogimi ligjor

Kur detyrimin e përmbush personi i cili ka ndonjë interes juridik në këtë çështje, atëherë i kalojnë këtij, në bazë të vet ligjit, në çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore.

NËNKREU 3
VONESA NË PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE NË TË HOLLA

Neni 382
Kamatëvonesa

1. *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën.*

2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

NËNKREU 6
KALIMI I TË DREJTAVE TË SIGURUARIT NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS NË SIGURUESIN (SUBROGIMI)

Neni 960
Subrogimi

1. *Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të*

drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin.

2. *Në qoftë se për faj të të siguruarit është bërë i pamundur ky kalim i të drejtave në sigurues tërësisht ose pjesërisht, siguruesi shkarkohet në masën përkatëse nga detyrimi i vet ndaj të siguruarit.*

3. *Kalimi i të drejtave nga i siguruari në sigurues nuk mund të jetë në dëmin e të siguruarit, kështu që në qoftë se shpërblimi të cilin e ka marrë i siguruari nga siguruesi për cilindo shkak qoftë është më i vogël nga sa është dëmi që ka pësuar, i siguruari ka të drejtë që prej pasurisë së personit përgjegjës t'i paguhet mbetja e kompensimit përpara kërkesës së siguruesit në bazë të të drejtave që janë kaluar në të.*

4. *Përjashtimisht nga rregullat mbi kalimin e të drejtave të të siguruarit në siguruesin, këto të drejta nuk kalohen në siguruesin, në qoftë se dëmin e ka shkaktuar personi në gjini në vijë të drejtë me të siguruarin, ose personi për sjelljet e të cilit përgjigjet siguruesi apo i cili bashkëjeton me të në të njëjtën ekonomi shtëpiake, ose personi që është punëtor i të siguruarit, përveç nëse këta persona e kanë shkaktuar dëmin me dashje.*

5. *Në qoftë se dikush nga personat e përmendur në paragrafin paraprak ka qenë i siguruar nga përgjegjësia, siguruesi mund të kërkojë nga siguruesi i tij kompensimin e shumës që i ka paguar të siguruarit.*

LIGJI NR. 04/L-018 PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGJEGJËSIA

Neni 26
Procedura e kërkesave për dëmshpërblim

1. Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me:
1.1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse;

1.2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit.

2. Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e kompletuar me prova dhe dokumentacion të nevojshëm për të vendosur për dëmshpërblimin, siguruesi është i detyruar që, më së largu në afat prej tri (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për dëmshpërblim, të njoftojë me shkrim të dëmtuarin duke precizuar me cilat nga provat dhe dokumentacioni duhet plotësuar kërkesën. Prej ditës së pranimit, respektivisht kompletimit të dokumentacionit të kërkesës, fillojnë të zbatohen afatet nga paragrafi 1. i këtij neni për detyrimin e siguruesit përkitazi me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.

3. BQK-ja nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e procedurave për dëmshpërblim, duke përfshirë edhe përcaktimin se kur konsiderohet e kompletuar kërkesa me prova dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vendosur lidhur me dëmshpërblimin.

4. Në pamundësi të përcaktimit të dëmit, respektivisht trajtimit të dëmshpërblimit në tërësi, siguruesi përgjegjës është i detyruar t'i paguajë palës së dëmtuar pjesën jokontestuese të dëmit në formë paradhënie, brenda afatit nga paragrafi 1. i këtij neni.

5. Në rast se siguruesi përgjegjës nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në Gjykatën Kompetente.

6. Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

7. Dispozitat nga paragrafi 1., 2., 4. dhe 5. të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në rastet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim të cilat janë detyrim i byrosë për dëmet nga baza e sigurimit kufitar dhe detyrimet e Fondit të kompensimit.

8. Në kërkesat për dëmshpërblim nga sistemi i kartonit ndërkombëtar të sigurimit zbatohen procedura dhe afate të posaçme sipas Marrëveshjes së Kretës.

Vlerësimi i pranueshmërisë e kërkesës

41. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

43. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme"*.

44. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

45. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

46. Për sa i përket përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj e të elaboruara më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [E.Rev.nr.68/2019] e 27 janarit 2020 të Gjykatës Supreme, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

47. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

48. Gjykata rikujton se aksidenti kishte ndodhur në vitin 2012. Ai ishte shkaktuar nga i siguruari i Kompanisë "Siguria", ndërsa i siguruari i parashtruesit të kërkesës B.I., kishte pësuar dëme materiale. Gjykata gjithashtu thekson se sipas parashtruesit të kërkesës, më 20 shtator 2013, është kërkuar riimbursimi përkatës nga Kompania "Siguria", dhe duke marrë parasysh që nuk është arritur marrëveshja, parashtruesi i kërkesës ka ushtruar padi pranë Gjykatës Themelore më 8 dhjetor 2015. Kërkesa për kompensim të dëmit material ishte aprovuar nga Gjykata Themelore, dhe ishte caktuar kamatëvonesa në lartësi prej 12% duke filluar nga 20 shtatori 2013 deri në pagesën definitive. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [III.Ek.nr. 561/2015] të 5 prillit 2018, arsyetoi përcaktimin e kamatëvonesës prej 12% duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm në lidhje me nenin 382 paragrafin 2 të LMD-së.

49. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ae.nr.130/2018], të 3 shtatorit 2019 aprovoi pjesërisht ankesën e Kompanisë "Siguria" dhe Aktgjykimin [III.Ek.nr. 561/2015] e 5 prillit 2018 të Gjykatës Themelore e ndryshoi vetëm sa i përket pjesës përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës, duke e detyruar Kompaninë "Siguria" që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë kamatëvonesën sipas normës vjetore prej 8 % në vit, duke konstatuar se Gjykata Themelore në këtë pikë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, respektivisht neni 26, paragrafi 6 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nuk është i aplikueshëm në rastet e kërkesave në bazë të të drejtës për subrogim, por në këtë rast është i aplikueshëm neni 382 i LMD-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, duke e kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit vetëm sa i përket pjesës së vendimit të saj përkitazi me kamatëvonesën. Në këtë rast, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit [E.Rev.nr.28/2019] të 27 janarit 2020 revizionin e parashtruesit të kërkesës e hodhi poshtë si të palejuar. Gjykata Supreme konstatoi se parashtruesi i kërkesës ka parashtruar revizion vetëm sa i përket çështjes se kamatëvonesës, dhe duke iu referuar nenit 30 paragrafit 2 të LPK-së, kamatëvonesa si kërkesë akcesore nuk merret parasysh nëse nuk përbën kërkesën kryesore, e cila në këtë rast është kërkesa për kompensim në bazë të të drejtës për subrogim, në vlerë prej 69.371, 63 euro. Për pasojë, Gjykata Supreme duke aplikuar paragrafin 2 të nenit 211 të LPK-së konstatoi se *"vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 €"*.

50. Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e lartcekura të Gjykatës Supreme, duke specifikuar se Aktvendimi i kontestuar është i përfshirë në shkelje të të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata rikujton se në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi pretendon: (i) mosarsyetim të vendimit gjyqësor; (ii) mohim të së drejtës së tij për qasje në gjykatë; dhe (iii) divergjencë në praktikën gjyqësore, si rezultat i vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme.

51. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të së drejtës së tij në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, ne lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

52. Këto dy kategori pretendimesh, përkatësisht cenimin e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe shkeljen e të drejtës në pronë, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Në vijim, Gjykata do t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për të vazhduar pastaj me shqyrtimin e pretendimeve lidhur me të drejtën e pronës.

I. Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

(i) Lidhur me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor

53. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kontekst të pretendimit të tij për mosarsyetim të vendimit gjyqësor konsideron se Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme i mungon arsyetimi adekuat për shkak se në mënyrë të gabuar është interpretuar paragrafit 2 i nenit 30 të LPK-së. Parashtruesi i kërkesës, në vijim nënvizon se arsyetimi i tij *"[...] mbështetet në konceptin e mirënjohur të së drejtës civile se "kamata ndan fatin e njëjtë të detyrimit kryesor", andaj mohimi i të drejtës ne shqyrtim gjyqësor me revizion ne rastin konkret del te jetë në kundërshtim me këtë koncept dhe si i tillë do të rezultonte përfundimi se kërkesëpadia për kamatëvonesën nuk mund të jetë objekt shqyrtimi me revizion respektivisht në një proces gjyqësor."* Në

vijim të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës specifikon se "*kamata, qoftë si kërkesë akcesore (duke e ndarë fatin e kërkesës kryesore – ne vlere prej 69,371.63 EURO) ashtu edhe si kërkesë e pavarur (që është objekt shqyrtimi edhe me revizion ne vlere prej 16, 956.45 Euro) rezulton me vlere te kontestit mbi shumen prej 10, 0000.000 Euro (konform dispozitës se nenit 50[9] te LPK) dhe si e tille e plotëson kushtet procedurale qe te jete objekt shqyrtimi me revizion*".

54. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës specifikon *se "[...] vlera e kërkesëpadisë kontestuese për kamate, qe ishte objekt i revizionit (dallimi në mes të normës vjetore 8% dhe 12%) është në vlerë prej 16,956.45 Euro. Andaj vendimi i Gjykatës Supreme për mos-lejimin e Revizionit te Parashtruesit bazuar ne kriterin e lartësisë se kërkesëpadisë sipas Ligjit te Procedurës Kontestimore qartazi tregon se arsyetimi i vendimit te Gjykatës Supreme jo vetëm se është i mangët por përbën edhe interpretim te gabuar te legjislacionit ne fuqi*".

55. Prandaj, duke u bazuar në pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, megjithëse ngrit çështjen e mosarsyetimit të vendimit, në thelb ai lidhur me dispozitat e nenit 30 të LPK-së pretendon interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit nga ana e Gjykatës Supreme.

56. Prandaj, bazuar në përmbajtjen e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimet për zbatim të gabuar të ligjit hyjnë në sferën e ligjshmërisë apo kushtetutshmërisë.

57. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih rastet nr. KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI75/17, parashtrues *X,* Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 55 dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).

58. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do

të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011; si dhe rastet e cekura më lart KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37, dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).

59. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih, rastin e GJEDNJ-së *Pronina kundër Rusisë*, kërkesa nr. 65167/01, Vendimi për pranueshmëri i 30 qershorit 2005; dhe rastet e Gjykatës të cituara më lart KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 38 dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).

60. Në këtë kuptim, Gjykata në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka theksuar se edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në aspektin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik e që mund të ketë rezultuar në *"konkluzione arbitrare"* apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin përkatës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc.*, Aktgjykim, paragrafi 83, *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 184/02, paragrafët 70-74 dhe 84; *Păduraru kundër Rumanisë*, nr. 63252/00, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], kërkesa nr. 33202/96, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bulgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih gjithashtu, rastin e Gjykatës cituar më lart KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57 dhe KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).

61. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës kërkesën e tij për revizion e kishte parashtruar kundër Aktgjykimit [Ae.nr.130/2018] të 3 shtatorit 2019, të Gjykatës së Apelit përkitazi me çështjen e lartësisë së kamatëvonesës. Po ashtu, Gjykata rikujton se në kërkesën e tij për

revizion parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar interpretim dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga Gjykata e Apelit në përcaktimin e lartësisë së kamatëvonesës, përkatësisht kur kishte vendosur që nuk është i aplikueshëm neni 26 paragrafi 6 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, porse në rastin e tij është i aplikueshëm neni 382 i LMD-së.

62. Gjykata vëren se, Gjykata Supreme kishte hedhur poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, duke konstatuar si në vijim:

> *"Në kuptim të nenit 30.2 të LPK, kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera akcesore, nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbëjnë kërkesën kryesore, ku në rastin konkret kërkesa kryesore është regresim i borxhit në shumë prej 69.371, 63 €, ndërsa kamata është akcesore, kështu që në kuptim të par. 1 të këtij neni si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore."*

63. Në kontekst të arsyetimit të Gjykatës Supreme, Gjykata i referohet nenit 30, të LPK-së, i cili përcakton:

> *"30.1 Paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi ta përcaktoj vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore.*
>
> *30.2 Kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera akcesore, nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbëjnë kërkesë kryesore."*

64. Gjykata Supreme përmes Aktvendimit të saj duke iu referuar paragrafit 2 të nenit 211 të LPK-së konstatoi se*: "Në nenin 211. 2 të LPK, parashihet që revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, poqë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 €. Së këndejmi revizioni i të autorizuarit të paditësit nuk është i lejuar".*

65. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se *" [...] në rastin konkret dhe nga gjendja e fakteve është evidente se kamata, qoftë si kërkesë akcesore (duke e ndarë fatin e kërkesës*

kryesore – ne vlere prej 69,371.63 EURO) ashtu edhe si kërkesë e pavarur (që është objekt shqyrtimi edhe me revizion ne vlere prej 16, 956.45 Euro) rezulton me vlere te kontestit mbi shumen prej 10, 0000.000 Euro (konform dispozitës se nenit 50[9] te LPK) dhe si e tille e plotëson kushtet procedurale qe te jete objekt shqyrtimi me revizion".

66. Bazuar në atë si më lartë, Gjykata ripërsëritë se Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore te gjykatave te rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime janë arbitrare ose qartazi te paarsyeshme (shih rastin e Gjykatës të cituar më lart, KI75/17, parashtrues *X,* paragrafi 59).

67. Megjithatë, bazuar në elaborimin e mësipërm, si dhe interpretimin dhe arsyetimin e dhënë nga Gjykata Supreme, në rastin konkret, nuk është dëshmuar që ka arbitraritet në interpretimin e dhënë nga Gjykata Supreme me rastin e hedhjes poshtë të revizionit të parashtruesit të kërkesës si të palejuar.

68. Gjykata, po ashtu vë në pah se parashtruesi në kërkesën e tij po ashtu specifikon se *"[...] kufizimi për Lejueshmërinë ose jo te revizionit mbështetet në vlerën e kontesteve pasurore juridike. Përndryshe, ne rastin konkret, kërkesa pasurore juridike ka te beje me "konteste tregtare" (përkitazi me te cilat lejohet revizioni ne kontestet me vlere mbi 10,000.00 Euro / Neni 508 i LPK) e jo siç; është theksuar ne arsyetimin e Aktvendimit te Gjykatës Supreme shuma prej 3,000.00 Euro (për çfarë rezulton se Gjykata Supreme nuk i është referuar drejte dispozitës respektive përkitazi me vlerën e kontestit ne rastin konkret si "kontest tregtar")".*

69. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se në kontestet tregtare, neni 508 i LPK-së përcakton që *"Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10.000 Euro."* Megjithatë, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme, arsyetimin e saj për hedhje poshtë të revizionit në mënyrë specifike e ka mbështetur duke u bazuar në nenin 30, paragrafin 2 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton që *"Kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera akcesore, nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbëjnë kërkesë kryesore".*

70. Andaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i mosarsyetimit të vendimit të Gjykatës Supreme, i cili ndërlidhet me çështjen e interpretimit dhe zbatimit të nenit 30, paragrafit 2 të LPK-së, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i "*dispozitave ligjore*" nga Gjykata Supreme, mund të ketë qenë "*qartazi i gabuar*", duke rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme"* për parashtruesin e kërkesës, apo se si procedura para Gjykatës Supreme mund të mos ketë qenë e drejtë ose edhe të ketë qenë arbitrare.

71. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi në kërkesën e tij nuk ka arritur te dëshmojë dhe te mbështesë pretendimin e tij se si Gjykata Supreme gjatë interpretimit dhe zbatimit të së drejtës materiale, respektivisht dispozitave të LPK-së ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Lidhur me pretendimin për mohim të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë

72. Gjykata rikujton se GJEDNJ ka konstatuar që neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së garanton "të drejtën në gjykatë", në kuadër të së cilës "e drejta për qasje", do të thotë e drejta për të filluar procedurat para gjykatës për çështje civile, përbën një aspekt të saj, si pjesë thelbësore e të drejtës për gjykim të drejtë. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund të kufizohet; këto kufizime janë të lejuara pasi e "drejta për qasje" për nga natyra e saj kërkon që kjo çështje të rregullohet nga shtetet veç e veç. Në këtë kuptim, shtetet gëzojnë një margjinë të vlerësimit, dhe vendimi përfundimtar për respektimin e kërkesave të së drejtës për një gjykim të drejtë i takon Gjykatës (shih, *mutatis mutandis,* rastin e GJEDNJ-së, *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 87/1997/871/1083, Aktgjykim i 28 tetorit 1998, para. 147; shih rastin e GJEDNJ-së, *Prince Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë,* nr. 42527/98, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 44).

73. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson se *"Meqë Parashtruesi ka shfrytëzuar të gjitha mjetet e rregullta juridike për të realizuar të drejtën e zhdëmtimit me*

kërkesën për subrogim në shkallë të parë dhe shkallë të dytë, një vendim i këtillë i Gjykatës Supreme me mangësi serioze në pjesën e arsyetimit përbën mohim të qasjes në drejtësi dhe përbën mos administrim të mirëfilltë të drejtësisë në rastin konkret." Në lidhje me këtë, parashtruesi në thelb pretendon se si rezultat i hedhjes poshtë të revizionit të tij si të palejuar përmes Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, kërkesa e tij për shqyrtimin e meritave të rastit përkitazi me kamatëvonesën, nuk ka arritur të trajtohet dhe shqyrtohet në merita nga kjo e fundit.

74. Në kontekst të këtij pretendimi, Gjykata rikujton se pas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, përmes së cilit pjesërisht ishte ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe atë vetëm sa i përket çështjes së lartësisë së kamatëvonesës, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar zbatim të gabuar të drejtës materiale nga ana e Gjykatës së Apelit, e cila kishte vendosur përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës prej 8% duke u bazuar në nenin 382, paragrafin 2 të LMD-së. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme revizionin e parashtruesit të kërkesës e kishte hedhur poshtë si të palejuar duke iu referuar nenit 30, paragrafit 2 dhe nenit 211 të LPK-së, dhe për pasojë duke konstatuar se *"vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 €."*.

75. Gjykata duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila ka theksuar se megjithëse secili ka të drejtë për të përdorur mjetet juridike kundër vendimeve administrative dhe gjyqësore, KEDNJ nuk e garanton të drejtën e ankesës nëse atë nuk e parasheh legjislacioni vendor (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Darnay kundër Hungarisë*, kërkesa nr. 36524/97, Vendim i 16 prillit 1998). Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion, përderisa përkitazi me kërkesën e tij për revizion, e cila i referohet çështjes së kamatëvonesës, Gjykata Supreme ka konstatuar se e njëjta bazuar në dispozitat përkatëse të LPK-së ishte e palejuar.

76. Prandaj, dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij përkitazi me mohimin e të drejtës së tij për qasje në gjykatë, dhe rrjedhimisht, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(iii) Lidhur me pretendimin e tij për divergjencë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme

77. Në lidhje me pretendimin e tij për divergjencë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës sqaron se *"[...] ka me dhjetëra raste të Gjykatës Supreme të Kosovës që në procedurën e revizionit është vendosur përkitazi me pretendimet për zbatimin e gabuar të drejtës materiale lidhur me kamatëvonesën respektivisht se në rastin konkret zbatohet kamatëvonesa prej 12% ne vit (sipas "lex specialis") [...]".*

78. Gjykata për arsye sqarimi thekson se ajo i ka vendosur parimet e përgjithshme përkitazi me mungesën e konsistencës, përkatësisht divergjencës në praktikën gjyqësore në kontekst të garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta në një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përmes Aktgjykimeve KI35/18, me parashtrues, *Bayerische Versicherungsverbrand,* Aktgjykim i 6 janarit 2020 dhe KI87/18, me parashtrues, *IF Skadeforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019.

79. Gjykata duke iu referuar edhe praktikës së vet gjyqësore, thekson se në raste të tilla, përkatësisht pretendimeve për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikën gjyqësore, parashtruesit e kërkesave duhet t'i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin e cituar më lartë KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverbrand*, paragrafi 76).

80. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon së në rastin e tij, Gjykata Supreme ka vendosur ndryshe duke konstatuar se kërkesa e tij për revizion duhet të hedhet poshtë si e palejuar. Në mbështetje të pretendimit të tij, parashtruesi i kërkesës i referohet dhe i ka dorëzuar katër (4) vendime të Gjykatës Supreme, respektivisht Aktvendimin [E. Rev. 43/2014] të 22 shtatorit 2014; dhe Aktgjykimet [E. Rev. 25/2014, të 13 majit 2014; [E. Rev. 23/2017] të 14 dhjetorit 2017; dhe [E. Rev. 27/2018] të 24 shtatorit 2018.

81. Në lidhje me Aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme [E. Rev. 25/2014, të 13 majit 2014; [E. Rev. 23/2017] të 14 dhjetorit 2017; dhe [E. Rev. 27/2018] të 24 shtatorit 2018, Gjykata vëren se këto aktgjykime në mënyrë specifike i referohen kërkesës për revizion kundër Aktgjykimeve të gjykatave të shkallës më të ulët, kërkesa të cilat janë parashtruar nga kompanitë e sigurimeve, dhe përveç çështjes së

kamatëvonesës si kërkesë aksesore, i referohen edhe kërkesës kryesore të paraqitur me padi, përkatësisht kërkesës përkitazi me kompensimin si rezultat i të drejtës në subrogim dhe kërkesës në lidhje me caktimin e lartësisë së kamatëvonesës. Përderisa Aktvendimi [E. Rev. 43/2014] të 22 shtatorit 2014 i Gjykatës Supreme i referohet konstatimit të kësaj të fundit për hedhjen poshtë si të palejuar të revizionit të parashtruar nga Kompania e Sigurimit kundër aktgjykimeve të gjykatave të shkallës më të ulët për arsye se vlera e kërkesës kryesore e gjykuar nga gjykata e shkallës më të ulët nuk e plotësonte kërkesën e parashtrimit të revizionit në bazë të nenit 508 të LPK-së. Përmes këtij Aktvendimi, Gjykata Supreme kishte konstatuar se *"[...] vlera e kontestit në padinë e paditëses të dorëzuar në gjykatë me datë 22.9.2011 është 7.143, 71 €, me parashtresën për precisimin e lartësisë së kërkesëpadisë të datës 13.9.2013, ndërsa me aktgjykimin e formës së prerë të goditur me revizion vlera e kontestit është caktuar në shumë prej 6.952, 88 €"*.

82. Megjithatë, Gjykata vlerëson se këto katër (4) vendime të Gjykatës Supreme, të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës nuk përmbajnë ngjashmëri faktike dhe procedurale, si në rastin e parashtruesit të kërkesës për arsye se në tri (3) aktvendimet e referuara nga parashtruesi i kërkesës, objekt shqyrtimi përmes revizionit kishte qenë jo vetë çështja e kamatëvonesës, por edhe çështja kryesore e kërkesëpadisë.

83. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës, në rrethanat e rastit konkret, nuk e ka përmbushur detyrimin që t'ia paraqesë Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendon se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij kushtetuese.

84. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ne kërkesën e tij nuk ka arritur të dëshmojë dhe të mbështesë pretendimin e tij për divergjencë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, dhe rrjedhimisht, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

II. Pretendimi për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

85. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se *"[...] dështimi i Gjykatës Supreme të Kosovës për të dhënë vendime te arsyetuara*

(dhe ne rastin konkret refuzimi arbitrar i revizionit të parashtruar" nga ai ka cenuar edhe të drejtën e pronës të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në mënyrë specifike, parashtruesi i kërkesës thekson se në rastin e tij ka pasur pritje legjitime që do të gëzojë dëmshpërblim në shumën e lartpërmendur sipas të drejtës në subrogim , përkatësisht *"të drejtën në rimbursim të dëmit të shkaktuar nga personi përgjegjës apo siguruesi i tij i përgjegjësisë mbi bazën e kamatës vjetore të përcaktuar me ligj"*.

86. Në këtë kontekst, Gjykata vë në pah se parashtruesi i kërkesës pretendimin e tij për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në mënyrë specifike e ndërlidhë me pretendimin e tij për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i mosarsyetimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Supreme. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton se përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të cilat në mënyrë specifike i referohen pretendimeve për mosarsyetim të vendimit, shkeljes së të drejtës së tij për qasje në gjykatë dhe divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme ka konstatuar se këto të fundit janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

87. Gjykata konsideron se edhe pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, dhe rrjedhimisht i papranueshëm ashtu siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

88. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse:

I. Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, që ndërlidhen me pretendimet (i) për mosarsyetim të vendimit gjyqësor; (ii) për shkelje të drejtës së tij në qasje në gjykatë; dhe (iii) cenimit të parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme janë të papranueshme sepse janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes nenit 47 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës; dhe

II. Pretendimi për shkelje të së drejtës së tij në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është i papranueshëm si qartazi

i pabazuar në bazë kushtetuese, siç është përcaktuar përmes nenit 47 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 të Ligjit dhe rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 26 mars 2021, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi

KI177/19, Parashtrues: NNT "Sokoli", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës , Ac.nr.2386/2018, të 17 majit 2019

KI177/19, Aktgjykim, i 29 marsit 2021, publikuar më 19 prill 2021

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë e pranueshme, shkelje e të drejtave kushtetuese*

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kontestoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2386/2018, të 17 majit 2019, në ndërlidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cp.nr.200/2016, të 13 prillit 2018.

Nga shkresat e rastit rezultoi se parashtruesi i kërkesës kishte lidhur Kontratë me Kompaninë "Kujtesa Net" Sh.p.k., sipas së cilës parashtruesi i kërkesës duhet të ndërtonte rrjetin kabllor optik dhe koaksial në territorin e Republikës së Kosovë, për nevojat e Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k., dhe e cila do të paguante për shërbimet e kryera. Pasi që "Kujtesa Net" Sh.p.k. nuk i kishte përmbushur obligimet që rrjedhin nga kjo kontratë, parashtruesi i kërkesës kishte iniciuar procedurë përmbarimore kundër "Kujtesa Net" Sh.p.k., të cilën e kishte aprovuar Gjykata Themelore në Prishtinë. Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. kishte ushtruar prapësim, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykata Themelore e kishte refuzuar prapësimin si të pabazuar. Pas ankesës së Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k. kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykata e Apelit e kishte aprovuar ankesën dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Gjykata Themelore, duke vepruar në rigjykim, kishte pranuar si të bazuar prapësimin e Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k. dhe kishte shfuqizuar në tërësi aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilat ishte lejuar përmbarimi. Ky vendim i Gjykatës Themelore ishte bazuar kryesisht në gjetjet të cilat i kishte bërë Gjykata e Apelit. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Apelit, kundër Vendimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paralelisht kishte dorëzuar edhe kërkesë për përjashtim të gjyqtarit H.Sh. nga shqyrtimi i lëndës së parashtruesit të kërkesës. Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac.nr.2368/2018, të 17 majit 2019, kishte refuzuar si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës. Gjykata e Apelit nuk kishte trajtuar fare kërkesën e parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit H.Sh. nga shqyrtimi i lëndës. Në të dyja rastet kur ishte gjykuar mbi rastin e parashtruesit të kërkesës, në Gjykatën e Apelit kishte gjykuar gjyqtari H.Sh., si gjyqtar i vetëm.

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendoi se i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Sipas parashtruesit të kërkesës, përmes vendimit të kontestuar janë shkelur tri parime të cilat garantohen me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, përkatësisht: (i) vendimi është nxjerrë nga një gjykatë e anshme; (ii) ai vendim nuk jep përgjigje në pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës; dhe (iii) procedura përmbarimore në këtë rast është tejzgjatur.

Gjykata vlerësoi se pretendimi i parë i parashtruesit të kërkesës, përkitazi me cenim të parimit të paanshmërisë së gjykatës, ndërlidhet ngushtë me pretendimin për mungesë të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Apelit. Rrjedhimisht, Gjykata këto dy pretendimet e para i trajtoi së bashku, për të vazhduar me pretendimin e radhës përkitazi me tejzgjatjen e procedurës.

Lidhur me pretendimin për cenim të parimit të paanshmërisë së gjykatës që ndërlidhet ngushtë me pretendimin për mungesë të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata vlerësoi se mos adresimi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit H.Sh., në procedurë të vendimmarrjes para kësaj gjykate, si dhe mungesa e arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Apelit përkitazi me pretendimin e tij për paanshmërinë e gjyqtarit H.Sh., të ngritur nga ai në ankesën e tij, përbën një të metë të pakapërcyeshme të aktgjykimi – në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata konstatoi se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit është i përfshirë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i mungesës së arsyetimit gjyqësor nga ana e Gjykatës së Apelit.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit për tejzgjatje të procedurës Gjykata konstatoi se lidhur me pretendimin e parashtruesit për tejzgjatje të procedurës, parashtruesi nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të të drejtës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk dëshmojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij këtë të drejtë kushtetuese.

Gjykata konstatoi se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2386/2018, i 17 majit 2019, është i pavlefshëm dhe se i njëjti kthehet në rigjykim.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI177/19

Parashtrues

NNT "Sokoli"

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit
të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2386/2018, të 17 majit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga NNT "Sokoli", me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Fehmi Shala, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2386/2018, të 17 majit 2019, në ndërlidhje me Aktvendimin Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cp.nr.200/2016, të 13 prillit 2018.

3. Parashtruesi i kërkesës Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr.2386/2018, të 17 majit 2019, e ka pranuar më 14 qershor 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të lartcekura, me të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 [Parimet e Përgjithshme] dhe 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 2 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 4 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu- Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).

8. Më 11 tetor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës së Apelit. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi edhe kompaninë "Kujtesa Net" Sh.p.k., në cilësi të palës së interesuar dhe i dërgoi një kopje të kërkesës.

9. Më 25 tetor 2019, Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k., e përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini", dorëzoi komentet e veta lidhur me kërkesën e parashtruesit.

10. Më 29 nëntor 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës lidhur me komentet e pranuara nga Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k.

11. Më 6 tetor 2020, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Apelit që ta njoftoj nëse Gjykata e Apelit e kishte pranuar dokumentin të cilin së bashku me shkresat e lëndës parashtruesi i kërkesës e kishte dorëzuar në Gjykatë dhe që kishte të bënte me kërkesën e tij drejtuar Gjykatës së Apelit për përjashtimin e gjyqtarit H.Sh., nga shqyrtimi i rastit të tij.

12. Më 15 tetor 2020, Gjykata e Apelit dorëzoi në Gjykatë përgjigjen e kërkuar.

13. Më 29 mars 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

14. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri konstatoi se (i) kërkesa është e pranueshme; dhe se (ii) Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2386/2018, i 17 majit 2019, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

15. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se më 12 shtator 2006 parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë biznesi me Kompaninë "Kujtesa Net" Sh.p.k., sipas së cilës parashtruesi i kërkesës duhej të ndërtonte rrjetin kabllor optik dhe koaksial në territorin e Republikës së Kosovë, për nevojat e Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k., dhe kjo e fundit do të paguante për shërbimet e kryera. Sipas kësaj kontrate, e cila ishte e lidhur për periudhë të pacaktuar kohore, parashihej që e njëjta mund të plotësohet, shkëputet apo modifikohet vetëm me pëlqimin e dyanshëm të palëve.

16. Më tutje rezulton se për shkak se Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. ishte në vonesë me realizimin e pagesave, më 30 tetor 2012, palët kontraktuese kishin nënshkruar një procesverbal që emërtohej "*Procesverbal për punët që ka kryer 'NNT Sokoli' për dobi të Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k. deri më datë 30 tetor 2010"*. Në këtë procesverbal specifikohej se parashtruesi i kërkesës nuk mund të faturojë punë të tjera për periudhën deri më 30 tetor 2010, përveç punëve të përfshira në specifikimin e këtij procesverbali.

17. Më 5 dhjetor 2012, parashtruesi i kërkesës dhe Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. kishin nënshkruar një marrëveshje të re, me nr. 949, ku parashihej që Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. duhej të paguante

borxhin e tërësishëm në vlerë prej 529,393.39 Euro, në 16 këste dhe se afati i fundit për pagesën e fundit ishte paraparë të jetë 16 shkurti 2014.

18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës, sipas marrëveshjes së lartcekur, i dërgon disa fatura tek Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. Me datën 7 mars 2014, Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. i kthen një shkresë parashtruesit të kërkesë të titulluar "REFUZIM", ku thekson: "*refuzojmë pranimin e këtyre faturave, pasi që nuk jemi në dijeni të këtyre faturave të arritura në zarf*". Parashtruesi i kërkesës, përsëri, vazhdoi me dërgimin e faturave të reja në adresë të Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k. dhe më 11 prill 2014 sërish këto fatura kthehen mbrapa në adresë të parashtruesit të kërkesës, nga ana e Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k., e cila refuzoi pranimin e tyre me të njëjtin arsyetim.

19. Më 4 prill 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti propozim për përmbarim në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik, me anë të së cilit kërkoi nga gjykata e lartpërmendur caktimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm/faturave (me nr. 001/14, 002/14, 003/14, 004/14, 027/12, 028/12, 029/12, 030/12, 031/12, 035/12, 036/12, 037/12, 038/12, 039/12 dhe 040/12 të gjitha të datës 1 mars 2014), në vlerë prej 261.324,12 eurosh (dyqind e gjashtëdhjetë e njëmijë e treqind e njëzet e katër euro e dymbëdhjetë cent).

20. Më 17 prill 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik, përmes Aktvendimit E.nr.567/14, e cakton përmbarimin ndaj Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k., për pagesën e borxhit në vlerë prej 261.324,12 eurosh (dyqind e gjashtëdhjetë e njëmijë e treqind e njëzet e katër euro e dymbëdhjetë cent).

21. Më 14 maj 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi propozimin e dytë për caktimin e përmbarimit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik, duke kërkuar kthimin e borxheve nga Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k., në bazë të faturave (me nr. 007/12, 016/12, 018/12, 019/12, 021/12, 022/12, 023/12, 024/12, 025/12, 026/12, 005/14, 006/14, 007/14, 008/14, 009/14 dhe 010/14, të gjitha të datës 7 prill 2014), në vlerë prej 297.968,31 eurosh (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë euro e tridhjetë e një cent).

22. Më 13 qershor 2014, Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. kishte parashtruar prapësim kundër Aktvendimit E.nr.567/14, të 17 prillit 2014, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik.

23. Më 24 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë që lënda e tij të " *transferohet në procedurë të mëtejme për përmbarim tek përmbaruesi privat E.M".*

24. Më 22 tetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik, përmes Aktvendimit E.nr.719/14, caktoi përmbarimin ndaj Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k., për pagimin e borxhit në vlerë prej 297.968,31 eurosh (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë euro e tridhjetë e një cent).

25. Më 28 prill 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik mbajti seancë gjyqësore. Në këtë seancë, pas propozimit të të autorizuarit të Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k. (debitor), i cili kishte kërkuar bashkimin e lëndëve përmbarimore (përkatësisht lëndës me nr. E.nr.567/14, me vlerë 261.324,12 eurosh dhe lëndës E.nr.719/14 me vlerë prej 297.968,31 eurosh), kjo Gjykatë vendosi bashkimin e lëndëve, duke e regjistruar me numër të ri, Cp.nr.200/16. I autorizuari i parashtruesit të kërkesës (kreditori) nuk kishte kundërshtuar bashkimin e këtyre lëndëve.

26. Në një datë të paspecifikuar, Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. kishte paraqitur prapësim kundër aktvendimeve E.nr.567/14 dhe E.nr.719/14 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik, për lejimin e përmbarimit, duke pretenduar se parashtruesi i kërkesës nuk e ka kryer punën ashtu siç pretendonte dhe se për një gjë të tillë është dashur të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet si në vijim: i) Pranimi teknik i punëve nga ana e kreditorit, ii) mungesa e vërejtjeve të kreditorit në punët e kryera, iii) mënjanimi i vërejtjeve eventuale të cilat do t'i kishte kreditori në punët e kryera nga debitori.

27. Parashtruesi i kërkesës, përmes përgjigjes në prapësim, kishte theksuar se punët e kryera dhe të papaguara nuk kishin pranim teknik, mirëpo as punët e mëparshme dhe të cilat janë paguar nga Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. nuk kishin pasur pranim teknik. Parashtruesi i kërkesës, më tej, argumentoi se Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. asnjëherë nuk kishte pasur ankesë në punën e parashtruesit të kërkesës dhe as në respektimin e afateve.

28. Më 30 dhjetor 2015, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar me një shkresë Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke kërkuar përshpejtim të shqyrtimit të lëndës.

29. Më 9 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me Akt Përcjellës nr. E.nr.567,719/2014, dërgoi shkresat e lëndës në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm Civil, duke konsideruar se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetente për të vendosur për këtë çështje përmbarimore, lidhur me prapësimin e këtyre dy lëndëve përmbarimore.

30. Më 20 korrik 2016, parashtruesi i kërkesës kishte drejtuar një letër Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Zyrës së Prokurorit Disiplinor, duke kërkuar " *Vlerësim të punës së gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë [A.K] dhe të përgjegjësve të tjerë në menaxhimin e lëndëve të kësaj Gjykate " II.E.567/14 dhe II.E.nr. 719/14*".

31. Më 2 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës sërish kishte dërguar shkresë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar përshpejtim të rastit të tij.

32. Më 13 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës kishte drejtuar një shkresë në Gjykatën Themelore në Prishtinë , " *Njoftim për shkelje të afateve ligjore*", duke pretenduar se për shkak të vonesave parashtruesit të kërkesës po i shkaktoheshin dëme të pariparueshme.

33. Më 23 tetor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, përmes Aktvendimit Cp.nr.200/2016, refuzoi si të pathemeltë prapësimin e Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k. Në arsyetimin e saj, Gjykata Themelore kishte arsyetuar se pretendimet e Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k. ishin të paqëndrueshme, pasi që nuk ishin ofruar prova në mbështetje të tyre.

34. Më 27 tetor 2017, Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k., kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit Cp.nr.200/2016, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, "sepse faturat nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë, ato nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori dhe se debitori nuk ka asnjë detyrim ndaj kreditorit".

35. Më 15 shkurt 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit Ac.nr.5040/17, miratoi si të themeltë ankesën e Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k. dhe anuloi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Cp.nr.200/2016, të 23 tetorit

2017, dhe çështjen e ktheu në rigjykim. Gjykata e Apelit në arsyetimin e saj theksoi si në vijim:

> "Gjykata *e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të procedurës përmbarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit ngase sipas nenit 40 të LPP-së, propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë kërkesën përmbarimore nga paragrafi 1, te nenit 38 te LPP-se, ku parashihet se: "propozimi për përmbarim duhet të përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi ...", në rastin konkret dokumenti i besueshëm nuk i plotëson kushtet për përmbarim ngase faturat janë të pa pranuara nga ana e debitorit dhe për të njëjtat nuk mund të vërtetohet nëse janë të nënshkruara nga vetë debitori ngase me parashtresën e datës 07.03.2014, debitori ka refuzuar pranimin e faturave pasi që nuk ka qenë në dijeni për faturat e mbërritura me zarf. Duke pasur parasysh Udhëzimin Administrativ Nr. 15/20 10, për zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku në nenin 20, paragrafi 1.1.17, përcaktohet se: 'në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruaj faturën tatimore', në rastin konkret kemi fatura të pa pranuara nga ana e debitorit [...] Në bazë të nenit 38, paragrafit 2 të LPP-së përcaktohet se: "në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafi 1, i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit për Procedurë Kontestimore", në rastin konkret organi përmbarues nuk ka vepruar konform ligjit, meqë me rastin e paraqitjes se propozimit për lejimin e përmbarimit organi përmbarues është dashur që propozimin për përmbarim t'ia kthej në plotësim kreditorit konform dispozitës së nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së [...] Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara më lartë, të caktoj seancë publike për të kuptuar validitetin e prapësimit sa i përket dokumentit të besueshëm-faturave, në atë mënyrë që kreditori edhe debitori të mund të prezantojnë provat e tyre lidhur me pretendimet ankimore, e pas kësaj të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave të LPP-së".*

36. Më 13 prill 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur në rigjykim, nxori Aktvendimin Cp.nr.200/2016, me të cilin pranoi tërësisht si të themeltë prapësimin e "Kujtesa Net" Sh.p.k. dhe shfuqizoi në tërësi Aktvendimin për lejimin e përmbarimit E.nr.567/14 dhe E.nr.719/14, të lejuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Gjykata Themelore, në arsyetimin e saj, potencoi se në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.5040/17], të 15 shkurtit 2018, theksohet në mënyrë të qartë se "*në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtët e cituara me lartë, të caktoj seancë publike për të kuptuar validitetin e prapësimit sa i përket dokumentit te besueshëm - faturave në mënyre qe Kreditori te mund te prezantojnë provat e tyre lidhur me pretendimet ankimore*".

37. Më 30 prill 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit Cp.nr.200/2016, të 13 prillit 2018, të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe shkelje të ligjit material.

38. Më 30 maj 2018, parashtruesi i kërkesës iu drejtua me kërkesë të veçantë Gjykatës së Apelit nga e cila kërkoi përjashtim të gjyqtarit H. Sh. nga shqyrtimi i lëndës, duke shprehur dyshime lidhur me paanësinë e gjyqtarit në fjalë, i cili kishte marrë një herë vendim lidhur me rastin e tij. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se gjyqtari në fjalë favorizon palën kundërshtare në këtë rast.

39. Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata e Apelit nuk i është përgjigjur parashtruesit lidhur me kërkesën e lartpërmendur.

40. Më 17 maj 2019, Gjykata e Apelit, duke vendosur përmes gjyqtarit individual H.Sh., përmes Aktvendimit Ac.nr.2386/2018, refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërteton Aktvendimin Cp.nr.200/2016, të 13 prillit 2018, të Gjykatës Themelore. Në arsyetim të këtij Aktvendimi, Gjykata e Apelit theksoi se vendimi i atakuar ishte i drejtë dhe i ligjshëm dhe se i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të procedurës përmbarimore, dhe gjendja faktike ishte konstatuar në mënyrë të drejtë. Më tutje, në arsyetim e saj, Gjykata e Apelit theksoi:

> *"Kjo Gjykatë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar aktvendimet për lejimin e përmbarimit E.nr.567/2014 dhe E.nr. 719/2014, të lejuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, ngase*

faturat e përshkruara në propozimin për përmbarim te datës 04.04.2014, e te cilat kërkohet te përmbarohen, nuk i plotësojnë kushtet për t'u konsideruar te përshtatshme për përmbarim. Duke pasur parasysh nenin 20, paragrafi 1.1.17 te Udhëzimit Administrativ Nr.15/2010, për zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, përcaktohet se: "në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është ne dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruaj faturën tatimore '., ashtu që në rastin konkret, nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, shihet se dokumenti i besueshëm - faturat në bazë të të cilave është lejuar përmbarimi, nuk janë nënshkruar nga debitori i përmbarimit. Nënshkrimi i faturës nga palët në marrëdhënie detyrimi, nuk paraqet vetëm një formalitet, por një veprim i tillë nënkupton pranimin e punëve të kryera nga kreditori dhe pohimin se ekziston borxhi i debitorit ndaj kreditorit konform faturave, andaj duke qenë se në rastin konkret faturat nuk janë nënshkruar, do të thotë se debitori nuk i ka pranuar ato fatura si të vetat, dhe si rrjedhojë te njëjtat nuk i përmbushin kushtet për të qenë të përshtatshme për përmbarim konform dispozitave te ligjeve ne fuqi."

Duke marrë parasysh pretendimet tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendime janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194, të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore"

41. Më 9 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi, në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Propozim për paraqitjen e Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, kundër Aktvendimit Ac.nr.2386/2018, të 17 majit 2019, të Gjykatës së Apelit. Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, kishte theksuar se "*me datë 01 qershor 2018, në Gjykatën e Apelit te Kosovës, kishte paraqitur kërkesë për përjashtim të gjyqtarit [H.Sh], nga gjykimi i çështjes që kishte të bënë me ankesën e paraqitur nga i autorizuari i kreditorit kundër aktvendimit Cp.nr 200/16 të datës 13.04.2018, për shkak të dyshimit në paanësinë e tij, dhe sipas deklarimit të paraqitësit të kërkesës "ky nga ky gjyqtar nuk pret vendim të drejtë , dhe ka bindje të thelle, se është ndikuar nga struktura në pushtet" . [...] Deri në ditën e marrjes së aktvendimit Ac.nr. 2386/2018 të datës 17 maj 2019, kreditori nuk ka marr asnjë njoftim nga Gjykata e Apelit e Kosovës, se është marrë fare vendimi*

lidhur me kërkesën e përfaqësuesit ligjor të kreditorit, për përjashtimin e gjyqtarit-kryetarit të Gjykatës se Apelit të Kosovës, nga gjykimi i kësaj çështjeje përmbarimore

42. Më 13 gusht 2019, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit KML.nr. 118/2019 njoftoi parashtruesin e kërkesës se propozimi i tij nuk është miratuar pasi që nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

43. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr.2386/2018, të 17 majit 2019, në ndërlidhje me Aktvendimin Cp.nr.200/2016, të 13 prillit 2018, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

44. Në thelb, parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar janë shkelur tri parime të cilat garantohen me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm: (i) e drejta për gjykim nga një gjykatë e paanshme; (ii) e drejta për vendim të arsyetuar; (iii) e drejta për gjykim brenda afati të arsyeshëm.

45. Gjykata vëren se dy pretendimet e para – që kanë të bëjnë me të drejtën për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe të drejtën për vendim të arsyetuar – janë paraqitur të ndërlidhura dhe mbi bazën e të njëjtave arsyetime. Si të tilla, Gjykata do t'i trajtojë së bashku. Ndërsa pretendimin përkitazi me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata do ta paraqesë ndaras.

i) E drejta për gjykim nga një gjykatë e paanshme në ndërlidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar

46. Lidhur me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës pohon se: "*Në të gjitha vendimet gjyqësore, të marra lidhur me këtë procedurë të përmbarimit, me përjashtim të aktvendimit të Cp.nr. 200/2016 i datës 23.10.2017, nga mënyra e vendosjes paraqitësi i kërkesës – kreditori* [Parashtruesi], *konsideron se gjykata ka treguar anshmëri, ndaj palës debitore, për faktin se, përkundër provave që kanë shkuar në favor të tij, çështja është vendosur ne favor të debitorit, dhe ky favorizim është manifestuar me aprovimin e kërkesës për rikthim të gjendjes se mëparshme, kur kanë munguar arsyet e vërteta ligjore, si dhe në shtyrjen e paarsyeshme e vendosjes për ketë çështje, e të cilat*

haptas janë shprehur me vendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. Nr.5040/17 dhe Ac.nr. 2386/2018 datë 17 maj 2019, të cilat vendime i ka marrë vet Kryetari Gjykatës se Apelit, H.Sh, ne cilësi te gjyqtarit individual.

47. Parashtruesi i kërkesës pretendon se për shkak të dyshimeve që ka pasur se Kryetari i Gjykatës së Apelit (H.Sh) në këtë rast e favorizon palën kundërshtare, kishte paraqitur kërkesë për përjashtim të tij, por se asnjëherë nuk ka marrë përgjigje në këtë kërkesë të tij dhe se e njëjta fare nuk është adresuar.

48. Parashtruesi i kërkesës më tutje shton se "*ky gjyqtar në trajtimin e çështjes konkrete ka treguar anshmëri të haptë, aq më tepër kur edhe vendimi i marrë, nuk paraqet as minimumin ligjor të një vendimi të arsyetuar*".

49. Parashtruesi i kërkesës thekson se: "*Duke vepruar ne kundërshtim të dispozitës se nenit 71 te LPK, gjyqtari-kryetari i Gjykatës se Apelit të Kosovës, [H. Sh.], duke vendosur për ankesën e kreditorit, kundër vendimit te gjykatës se shkalles se parë, kur ka ekzistuar kërkesa për përjashtimin e tij, ka bërë shkelje thelbësore të dispozitës së nenit 182 paragrafi 2 pika nen c) te Ligji për Procedurën Kontestimore. Shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182 paragrafi 2 janë me rëndësi absolute, dhe për pasoje kanë anulimin e vendimit te marr*".

50. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se "*Gjykata e Apelit ne aktvendimin e saj është dashur të jep përgjigje në të gjitha pretendimet nga ankesa e kreditorit, qe kishin te bëjnë me faktin, se debitori e mban përgjegjësinë për kthimin e faturave prapa duke ditur se kane te bëjnë me një pune që e ka kryer kreditori dhe debitori e ka marrë në shfrytëzim [...] Funksioni thelbësor i një vendimi te arsyetuar nga gjykata e shkallës së dytë, është që me anë të vendimit duhet t'i tregoj palës se pretendimi i tij ankimor është lexuar, dhe gjykata ka kuptuar ankesën e tij, dhe duke dhëne përgjigje në pretendime te ankuesit, te bind palën se për cilat arsye është marrë apo nuk është marrë në konsiderim pretendimi ankimor. Vendim i shkallës së dytë bëhet pasi këtë e ka kërkuar pala me ankesë, dhe është funksioni thelbësor i gjykatës së shkallës së dytë të bind palën me anë të argumenteve se në ato pretendime nga ankesa ka apo nuk ka të drejtë*".

ii) E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

51. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se në bazë të nenit 6 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, parashihet se organi përmbarues ka për detyrë të veproj me ngutshmëri, në bazë të afateve të cilat i parasheh Ligjit i Procedurës Përmbarimore. Në rastin e tij, parashtruesi i kërkesës pretendon se: " *Procedura përmbaruese, për të cilën u paraqiten dy propozime për përmbarim, në muajin prill 2014, përfundoi me vendim të formës se prerë pas pesë (5) viteve, nga momenti i fillimit kur objektivisht kanë mund te kryhet për 5-6 muaj. Është me se evidente se është fjala për një gjykim jashtë afatit te arsyeshëm, që haptas flet për një gjykatë qe nuk është e pavarur, por është nën ndikimin e palës debitore".*

52. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulojë Aktvendimin Ac.nr.2386/2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 17 majit 2019, dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Komentet e dorëzuara nga Gjykata e Apelit

53. Në përgjigjen e saj drejtuar Gjykatës Kushtetuese pas kërkesës së kësaj të fundit, lidhur me konfirmimin nga ana e Gjykatës së Apelit nëse e kishin pranuar shkresën e parashtruesit lidhur me përjashtimin e Gjyqtarit H.Sh. nga shqyrtimi i rastit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ka theksuar si në vijim:

> "*Duke e parë se kishin mbetur lëndë përmbarimore të vitit 2018, të pa zgjidhura, kryetari i gjykatës i mbledhë për ti zgjidhur ma shpejt me 11.03.2019, ngarkohet 25 lëndë, e në mesin e tyre është edhe AC. nr.2386/18. Kërkesa për përjashtim e cila është pranuar ne Gjykatën e Apelit 01.07.2018, kur ka arritur në gjykatë , lënda ishte te gjyqtari tjetër , meqenëse se lënda ishte te Gjyqtari G.A, nuk ka vendosur lidhur me kërkesën për përjashtim*".

Komentet e dorëzuara nga Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k.

54. Pas njoftimit nga ana e Gjykatës, duke i dhënë mundësinë për komente, në përgjigjen e saj drejtuar Gjykatës, Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k, kishte deklaruar se të gjitha çështjet të cilat parashtruesi i kërkesës i kishte ngritur në kërkesën e tij nuk qëndrojnë.

55. Lidhur me pretendimin e parë të parashtruesit të kërkesës, Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. pohon se " *Me pretendimin si me lartë Parashtruesi shpreh vetëm pakënaqësi me mënyrën e vlerësimit të provave, por nuk tregon se cilat janë ato rrethana të parashikuara me dispozitat e Ligjit te Procedurës Kontestimore, e të cilat përligjin konstatimet për pa-anshmëri të gjykatës*. Më tutje, lidhur me

pretendimin e parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit H.Sh., nga gjykimi i çështjes, Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. i referohet neneve përkatëse të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilët përcaktojnë se Gjykata mund ta hedhë poshtë kërkesën për përjashtim kur e njëjta nuk është e arsyetuar.

56. Lidhur me pretendimin e parashtruesit për tejzgjatje të procedurës, Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k., deklaron se: "*Gjykimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm, mund të jetë shkelje e mëvetësishme dhe tejkalimi i afateve të arsyeshme për t'i dhëne çështjes juridike epilog final nuk ka të bëjë me pa-anshmërinë e gjykatës. Nëse çështja nuk gjykohet brenda një afati të arsyeshëm kjo nuk do te thotë se gjykata (nuk) ka qenë e pa-anshme. Gjykimi i çështjes brenda një afati te arsyeshëm nuk është ne interes vetëm për kreditorin por edhe për debitorin, ngase edhe ai ka interes qe brenda një afati te arsyeshëm te sqaroj pozicionin e vet ne lidhje me pretendimet e kreditorit. Prandaj, ky argument te cilin Parashtruesi e përdorë për te dëshmuar pa-anshmërinë e gjykatës është i papranueshëm.*

57. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për mosarsyetim të vendimit, Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. thekson se vendimi i kontestuar është mjaftueshëm i arsyetuar.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj*

(...)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si

për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
(...)

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 63

Në qoftë se gjykata kompetente, nga shkaku i përjashtimit të gjyqtarëve apo nga ndonjë shkak tjetër nuk mund të procedoj, atëherë ajo do ta njoftoj për këtë gjykatën e shkallës më të lartë me qëllim që ta caktoj një gjykatë tjetër nga territori i vet, por që është e kompetencës lëndore për çështjen konkrete

Neni 67
Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike:

a) në qoftë se është vetë palë, përfaqësues ligjor apo me prokurë i palës, apo në qoftë se me palën është bashkëkreditor apo bashkëdebitor ose i obliguar për regresim, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert;

[...]

g) në qoftë se ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij.

Neni 71

71.1 Gjykatësi posa ta kuptojë së është shtruar kërkesa për përjashtimin e tij ose ekzistojnë shkaqet për përjashtimin e tij sipas nenit 67 të këtij ligji, është i detyruar ta ndërpresë procedimin dhe ta njoftojë kryetarin e gjykatës.

71.2 Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kur kërkesa për përjashtim është bazuar në nenin 67 pika g , gjykatësi e njofton

kryetarin e gjykatës dhe mund ta vazhdojë procedimin derisa të vendoset lidhur me kërkesën për përjashtim, vetëm të atyre veprimeve që rrezikohen nga shtyrja

71.3 Kryetari i gjykatës, kur kërkohet përjashtimi i tij, e cakton zëvendësin nga radhët e gjykatësve të gjykatës së çështjes, nëse një gjë e tillë nuk është e mundur, vepron sipas nenit 63 të këtij ligji.

Neni 182

182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejt ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

a) në qoftë se gjykata është përbërë jo sipas dispozitave ose në çoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari që nuk ka marrë pjesë në seancën kryesore;

b) në qoftë se është vendosur për kërkesën e cila nuk bënë pjesë në juridiksionin gjyqësor;

c) në çoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili sipas ligjit duhet të përjashtohet, respektivisht me vendim të gjykatës ka qenë i përjashtuar ose me rastin e dhënies se vendimit ka marrë pjesë personi i cili nuk e ka cilësinë e gjyqtarit;

[...]

Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore

Neni 77

Ankesa kundër vendimit lidhur me prapësimin

1. Palët kanë të drejtë ankese kundër vendimit mbi prapësimin.

2. Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes

Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit.

3. Një kopje e ankesës u dorëzohet palës kundërshtare dhe pjesëmarrësve tjerë të cilët mund të paraqesin përgjigje në ankesë në afat prej tre (3) ditëve.

4. Pas pranimit të përgjigjes në ankesë ose pas kalimit të afatit për përgjigje, lënda së bashku me të gjitha shkresat tjera i dërgohet Gjykatës së shkallës së dytë në afat prej tre (3) ditësh. Lidhur me ankesën, Gjykata e shkallës së dytë do të vendosë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr. 15 /2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT

Neni 20
Faturat dhe Kuponët e Regjistruesit të Kesh-it

1. Kërkesat për faturim për transaksionet në mes të personave të tatueshëm: Një faturë me TVSh, e njohur si faturë tatimore, kërkohet të lëshohet nga të gjithë tatimpaguesit të cilat janë të detyruar të paguajnë TVSh për secilin transaksion në të cilin përfshihet furnizimi i mallrave apo shërbimeve për personin tjetër të tatueshëm (personi i cili është i regjistruar në TVSh, apo kërkohet të regjistrohet në TVSh), qoftë ai person tjetër shoqëri tregtare, që do të kalojë shërbimin apo mallrat te personi tjetër, apo është konsumatori përfundimtar. Fatura duhet të lëshohet në së paku në dy kopje origjinale, një për shitësin dhe një për klientin apo blerësin.
1.1. Fatura tatimore duhet te përmbajë elementet vijuese:
[...]
1.1.17. Në minimum, një faturë duhet të jetë nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

58. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

59. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

60. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".

61. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë për aq sa janë të zbatueshme (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës Universiteti AAB RIINVEST L.L.C., Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

62. Gjykata, gjithashtu, vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë të përcaktuara në nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, si dhe në rregullin 39 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa Individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

Rregulli 39
Kriteret e pranueshmërisë

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar,
(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar,
(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit 20 efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe
(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij
[...]

63. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, në pajtim me nenet 21 (4) dhe 113 (7) të Kushtetutës dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e parashikuar në nenin 49 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës, poashtu, saktësisht ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë cenuar dhe aktet e autoriteteve publike që i konteston, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit.

64. Në dritën e fakteve dhe argumenteve të paraqitura me këtë kërkesë, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze kushtetuese, të

cilat kërkojnë shqyrtim të meritave të kërkesës. Për më tepër, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar, brenda kuptimit të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe nuk ekziston asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme.

65. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e rastit

66. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte lidhur Kontratë me Kompaninë "Kujtesa Net" Sh.p.k., sipas të cilës parashtruesi i kërkesës duhet të ndërtonte rrjetin kabllor optik dhe koaksial në territorin e Republikës së Kosovë, për nevojat e Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k., dhe e cila do të paguante për shërbimet e kryera. Pasi që "Kujtesa Net" Sh.p.k. nuk i kishte përmbushur obligimet që rrjedhin nga kjo kontratë, parashtruesi i kërkesës kishte iniciuar procedurë përmbarimore kundër "Kujtesa Net" Sh.p.k., të cilën e kishte aprovuar Gjykata Themelore në Prishtinë. Kompania "Kujtesa Net" Sh.p.k. kishte ushtruar prapësim, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykata Themelore e kishte refuzuar prapësimin si të pabazuar. Pas ankesës së Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k. kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykata e Apelit e kishte aprovuar ankesën dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Gjykata Themelore, duke vepruar në rigjykim, kishte pranuar si të bazuar prapësimin e Kompanisë "Kujtesa Net" Sh.p.k. dhe kishte shfuqizuar në tërësi aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilat ishte lejuar përmbarimi. Ky vendim i Gjykatës Themelore ishte bazuar kryesisht në gjetjet të cilat i kishte bërë Gjykata e Apelit. Pas ankesës së parashtruesit në Gjykatën e Apelit, kundër Vendimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi paralelisht kishte dorëzuar edhe kërkesë për përjashtim të gjyqtarit H.Sh. nga shqyrtimi i lëndës së parashtruesit. Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac.nr.2368/2018, të 17 majit 2019, kishte refuzuar si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës. Gjykata e Apelit nuk kishte trajtuar fare kërkesën e parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit H.Sh. nga shqyrtimi i lëndës. Në të dyja rastet kur ishte gjykuar mbi rastin e parashtruesit të kërkesës, në Gjykatën e Apelit kishte gjykuar gjyqtari H.Sh., si gjyqtar i vetëm.

67. Përkitazi me këtë të fundit, përkatësisht Aktgjykimin Ac.nr.2368/2018, të 17 majit 2019, të Gjykatës së Apelit, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon që i njëjti është në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Sipas

parashtruesit të kërkesës, përmes vendimit të kontestuar janë shkelur tri parime të cilat garantohen me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, përkatësisht: (i) vendimi është nxjerrë nga një gjykatë e anshme; (ii) ai vendim nuk jep përgjigje në pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës; dhe (iii) procedura përmbarimore në këtë rast është tejzgjatur.

68. Në vazhdim, Gjykata pretendimet e parashtruesit do t'i shqyrtojë ndaras, për aq sa ato mund të trajtohen ndaras. Gjykata rithekson se pretendimi i parë i parashtruesit të kërkesës, përkitazi me cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatës, ndërlidhet ngushtë me pretendimin për mungesë të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Apelit. Rrjedhimisht, Gjykata këto dy pretendimet e para do t'i trajtojë së bashku, për të vazhduar me pretendimin e radhës përkitazi me tejzgjatjen e procedurës.

69. Në këtë drejtim, pretendimet e lartcekura Gjykata do të i trajtojë duke u referuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), mbi bazën e së cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(i) Përkitazi me pretendimin se vendimi është nxjerrë nga një gjykatë e anshme dhe se vendimi i kontestuar nuk jep përgjigje në pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës

70. Gjykata rikujton edhe një herë pretendimin e parashtruesit të kërkesës, i cili thekson se "*Në të gjitha vendimet gjyqësore, të marra lidhur me këtë procedurë të përmbarimit, me përjashtim të aktvendimit të Cp.nr. 200/2016 i datës 23.10.2017, nga mënyra e vendosjes paraqitësi i kërkesës - kreditori, konsideron se gjykata ka treguar anshmëri, ndaj palës debitore, për faktin se, përkundër provave që kanë shkuar në favor të tij, çështja është vendosur ne favor te debitorit, dhe ky favorizim është manifestuar me aprovimin e kërkesës për rikthim të gjendjes se mëparshme, kur kanë munguar arsyer e vërteta ligjore, si dhe në shtyrjen e paarsyeshme e vendosjes për këtë çështje, e të cilat haptas janë shprehur me vendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. Nr.5040/17 dhe Ac.nr. 2386/2018 datë 17 maj 2019, të cilat vendime i ka marrë vet Kryetari Gjykatës se Apelit, H.Sh, në cilësi te gjyqtarit individual*".

71. Në lidhje me të lartcekurat, parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pasur informata se Kryetari i Gjykatës së Apelit gjyqtari (H.Sh) në këtë rast e favorizon palën kundërshtare.

72. Parashtruesi në kërkesën e tij thekson se "*ky gjyqtar në trajtimin e çështjes konkrete ka treguar anshmëri të haptë, aq më tepër kur edhe vendimi i marrë, nuk paraqet as minimumin ligjor të një vendimi të arsyetuar*".

73. Parashtruesi i kërkesës, dyshimin për paanshmëri dhe çështjen e (mos)përjashtimit të gjyqtarit H.Sh., e ka ndërlidhur me pretendimin për mos arsyetim të vendimit gjyqësor. Kështu, parashtruesi në kërkesën e tij para Gjykatës specifikon që në këtë rast Gjykata e Apelit, duke mos u përgjigjur në kërkesën e tij për përjashtim të gjyqtarit H.Sh., ka cenuar parimin e paanshmërisë së gjykatës, si dhe, duke mos adresuar fare kërkesën e tij, ka shkelur parimin e vendimit të arsyetuar. Në këtë ndërlidhje, parashtruesi pretendon se aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ka dështuar të japë përgjigje në të gjitha pretendimet e tij.

74. Në këtë sfond, Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesit se "*Kreditori* [parashtruesi], *fare nuk merr përgjigje për kërkesën e tij për përjashtim të gjyqtarit-kryetarit të gjykatës, nga gjykimi i çështjes së tij sipas ankesës së paraqitur[...] Gjyqtari kryetari i Gjykatës z.[H.Sh] si njohës i mirë i ligjit, duke ditur për pasojat dhe përgjegjësit për mosraportim të kërkesës për përjashtim, dhe përkundër këtij fakti, vendos për rastin, nga i cili kërkohet të përjashtohet, dhe me këtë ka treguar këmbëngulësinë e tij në trajtim të çështjes, dhe ka treguar faktin se kërkesa e përfaqësuesit të kreditorit për përjashtimin e tij ishte e bazuar. Qartë ky gjyqtarë, në trajtimin e çështjes konkrete ka treguar anshmëri të haptë, aq më tepër kur vendimi i marrë nuk paraqet as minimum ligjor të një vendimi të arsyetuar [...]Gjykata e Apelit ne aktvendimin e saj është dashur te jep përgjigje në te gjitha pretendimet, e nga ankesa e kreditorit, qe kishin te bëjnë me faktin, se debitori e mban përgjegjësi për kthimin e faturave prapa duke ditur se kanë të bëjnë me një punë që e ka kryer kreditori dhe debitori e ka marrë në shfrytëzim*".

75. Në dritën e këtyre argumenteve të parashtruesit, Gjykata së pari rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit Cp.nr.200/2016 të Gjykatës Themelore, dhe në të njëjtën kohë kishte paraqitur edhe kërkesë të veçantë për përjashtimin e gjyqtarit H.Sh. nga gjykimi i çështjes së tij, duke i paraqitur edhe arsyet se pse e kërkon përjashtimin e gjyqtarit (i cili kishte vendosur edhe në bazë të ankesës së "Kujtesa Net" sh.p.k.

kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cp.nr.200/16, të 23 tetorit 2017 dhe të njëjtën e kishte pranuar dhe e kishte kthyer çështjen në rigjykim).

76. Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit Ac.nr.2368/2018, të 17 majit 2019, kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe kishte vërtetuar Aktvendimin Cp.nr.200/2016 të Gjykatës Themelore.

77. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës edhe në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë, të parashtruar në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, kishte theksuar se përkundër kërkesës së tij për përjashtimin e gjyqtarit H.Sh., nga shqyrtimi i rastit të tij, parashtruesi asnjëherë nuk kishte marrë përgjigje lidhur me këtë pretendim. Gjykata rikujton se më 13 gusht 2019, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit KML.nr. 118/2019 njoftoi parashtruesin e kërkesës se propozimi i tij nuk është miratuar pasi që nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për mbrojtje të ligjshmërisë

78. Nga shkresat e lëndës Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk kishte marrë përgjigje lidhur me kërkesën për përjashtim të gjyqtarit, të paraqitur në Gjykatën e Apelit, as me ndonjë shkresë të veçantë apo me ndonjë vendim të ndërmjetëm.

79. Për më tepër, gjyqtari në fjalë, i cili nga parashtruesi i kërkesës ishte kërkuar të përjashtohet, kishte vendosur sërish si gjyqtar i vetëm, me rastin e nxjerrjes së Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.2386/2018, të 17 majit 2019.

80. Gjykata vëren se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Ac.nr.2386/2018, i 17 majit 2019, askund nuk i referohet pretendimit të parashtruesit për paanshmërinë e gjyqtarit H.Sh. dhe as kërkesës së tij që ai gjyqtar të përjashtohet nga gjykimi i rastit.

81. Për më tepër, kjo konfirmohet edhe nga vetë përgjigja e Gjykatës së Apelit, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ku shihet se Gjykata e Apelit nuk kishte vendosur asnjëherë lidhur me kërkesën e parashtruesit për përjashtimin e gjyqtarit H.Sh.

82. Në dritën e kësaj, Gjykata vë theksin në faktin se pretendimet e parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me garancitë procedurale që ofron neni 31 i Kushtetutës (përkatësisht, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm), në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ. Gjykata fillimisht e konsideron të nevojshme të vë në pah se garancitë e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së shtrihen përgjatë tërë

procedurave kur vendoset për të drejta dhe detyrime të palëve. GJEDNJ ka potencuar se vendosja lidhur me një të drejtë nënkupton jo vetëm përcaktimin e ekzistimit të saj, por edhe fushëveprimin (shtrirjen) si dhe mënyrën sesi ajo duhet të ushtrohet (shih, *mutatis mutandis*, vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Torri kundër Italisë*, Aktgjykim i 23 janarit 1996; *Buj kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 1 shtatorit 2009, paragrafi 19).

83. Në rastin konkret, Gjykata vë theksin në thelbin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me mosarsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata i referohet qëndrimit konsistent të GJENDJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese, se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar. Kjo do të thotë se gjykatat duhet "*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre*" (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykimi i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33; shih rastin e Gjykatës KI97/16, me parashtrues "*IKK Classic*", Aktgjykim i 9 janarit 2018) Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ dhe Gjykatës Kushtetuese, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument apo pretendim të parashtruesve. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Megjithatë, pretendimet dhe argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih *mutatis mutandis* rastin e Gjykatës KI97/16, me parashtrues "*IKK Classic*", Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 54; KI143/16, me parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 majit 2018, paragrafi 54, shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61, *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 24 majit 2005 dhe *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006).

84. Në rastin konkret, Gjykata vë në pah se Gjykata e Apelit, në Aktvendimin e saj, nuk mori fare parasysh pretendimet e parashtruesit për pjesëmarrjen e gjyqtarit H.Sh., si gjyqtar i vetëm në gjykimin e çështjes së parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Apelit, edhe pse parashtruesi i kërkesës paralelisht me ankesën i ishte drejtuar Gjykatës së Apelit me kërkesë të veçantë që gjyqtari në fjalë të përjashtohet nga gjykimi i çështjes, duke shprehur dyshime lidhur me paanësinë e tij.

85. Gjykata dëshiron të qartësojë se, edhe pse parashtruesi ngre pretendime për paanshmërinë e gjykatës (gjyqtarit), thelbi i argumenteve të paraqitura nga ai kanë të bëjnë me shpërfilljen e tërësishme nga ana e Gjykatës së Apelit, të kërkesës së tij për përjashtimin nga vendimmarrja në rastin e tij të gjyqtarit H.Sh.

86. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata e konsideron të rëndësishme të sqarojë, *obiter dictum*, se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, "paanshmëria" nënkupton mospasjen e paragjykimeve apo animeve nga ana e gjykatave, kur gjykojnë raste konkrete (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ, *Hauschild kundër Danimarkës*, Aktgjykim i 24 majit 1989). Më tutje, GJEDNJ ka sqaruar se kur është në pyetje paanshmëria personale e gjyqtarit, gjyqtari prezumohet i paanshëm derisa nuk provohet e kundërta (shih rastin e GJEDNJ, *Kyprianou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2005). Kur një pretendim i tillë ngrihet në GJEDNJ, ajo zbaton të ashtuquajturin *test subjektiv*, që nënkupton se duhet të dëshmohet me fakte se a ka shfaqur anëtari i gjykatës "anim personal" ndaj parashtruesit të kërkesës (shih vendimin e GJEDNJ në rastin, *Hauschild kundër Danimarkës*, Aktgjykim i 24 majit 1989).

87. Sidoqoftë, në rastin konkret, pa paragjykuar lidhur me vërtetësinë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për mungesën e paanshmërisë së gjyqtarit në fjalë, Gjykata nuk mund të anashkalojë faktin se Gjykata e Apelit ka qëndruar tërësisht e heshtur ndaj kërkesës së parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e atij gjyqtari nga procesi i vendimmarrjes në rastin e tij.

88. Gjykata vlerëson se, sikur Gjykata Apelit në Aktvendimin e saj të adresonte pretendimet e përsëritura të parashtruesit lidhur me paanshmërinë e gjyqtarit H.Sh – pavarësisht përgjigjes që do t'i jepej kërkesës dhe pretendimeve të tij (pra, pavarësisht nëse ato do të pranoheshin apo jo) – atëherë gjithsesi se do të përmbushej kushti i "palës së dëgjuar" dhe i administrimit të duhur të drejtësisë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të ekzaminojë deri në çfarë mase janë të arsyeshme pretendimet e parashtruesve në procedurat pranë gjykatave të rregullta. Megjithatë, drejtësia procedurale e kërkon që pretendimeve thelbësore të ngritura nga palët në gjykatat e rregullta duhet dhënë përgjigje në mënyrën e duhur - posaçërisht nëse kanë te bëjnë me çështje të rëndësishme sikurse paanshmëria e gjykatave. (shih në mënyrë të ngjashme vendimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 2 majit 2017, paragrafi 47).

89. Prandaj, bazuar në atë si më sipër, Gjykata konsideron se çështja e adresimit të kërkesës dhe pretendimeve të parashtruesit për përjashtimin e gjyqtarit është e karakterit thelbësor për rastin sepse qartësimi i saj do të evitonte frikën objektive të parashtruesit lidhur me paanshmërinë e gjykatës në gjykimin e rastit të tij dhe do të forconte bindjen se pretendimet e parashtruesit janë dëgjuar në mënyrë të duhur (shih në mënyrë të ngjashme vendimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 2 majit 2017, paragrafi 46; KI 135/14, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 10 nëntorit 2015).

90. Gjykata vë në pah se dukja e paanshmërisë së gjykatave është e rëndësishme, në dritën e postulatit juridik se "drejtësia nuk duhet vetëm të bëhet, por ajo duhet edhe të shihet që po bëhet". Ky është element qenësor i besimit që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të ngjallin te publiku (shih, *Volkov kundër Ukrainiis,* par. 106, aktgjykim i GJEDNJ-se 2013 dhe *De Cubber kundër Belgjikes,* 26 tetor 1984, § 26, Seria Anr. 86, gjithashtu shih rastin e Gjykatës në rastin KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 2 majit 2017, paragrafi 49; KI 24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019, paragrafi 47).

91. Si përfundim, Gjykata vlerëson se mosadresimi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit H.Sh., në procedurë të vendimmarrjes para Gjykatës së Apelit, si dhe mungesa e arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Apelit përkitazi me pretendimin e tij për paanshmërinë e gjyqtarit H.Sh., të ngritur nga ai në ankesën e tij, përbën një të metë të pakapërcyeshme të aktgjykimit – në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ.

92. Prandaj, Gjykata konstaton se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit është i përfshirë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i mungesës së arsyetimit gjyqësor nga ana e Gjykatës së Apelit.

(ii) E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

93. Në trajtim të këtij pretendimi, Gjykata fillimisht rikujton edhe një herë këtë pretendim të parashtruesit, i cili ndër të tjera thekson se natyra e procedurës përmbarimore është urgjente dhe në rastin e tij janë tejkaluar të gjitha afatet të cilat janë të parapara me ligjin për procedurën përmbarimore.

94. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson "*Procedura përmbaruese, për të cilën u paraqiten dy propozime për përmbarim,*

në muajin prill 2014, përfundoi me vendim të formës se prerë pas pesë (5) viteve, nga momenti i fillimit kur objektivisht kanë mund të kryhet për 5-6 muaj. Është me se evidente se është fjala për një gjykim jashtë afatit të arsyeshëm, që haptas flete për një gjykatë që nuk është e pavarur, por është nën ndikimin e palës debitore".

95. Gjykata sjell në vëmendje se çështjen e tejzgjatjes parashtruesi e ka ngritur edhe në gjykatat e rregullta, duke pretenduar se në rastin e tij tejzgjatja po ndodh qëllimshëm dhe duke theksuar se këto të fundit e kanë anashkaluar faktin se procedura pëmbarimore është e natyrës urgjente.

96. Përkitazi me pretendimin për tejzgjatje të procedurës, Gjykata fillimisht vë në dukje qëndrimin parimor të GJEDNJ se neni 6 (1) i KEDNJ-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një kohe të arsyeshme, (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, në çështjen *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 1 prillit 2014, paragrafi 91).

97. *Sa i përket shtrirjes në kohë të procedurave,* Gjykata merr parasysh kriteret e GJEDNJ të përcaktuara në Aktgjykimin e rastit *Tomazič kundër Sllovenisë*, (Aktgjykimi i 2 qershorit 2008, paragrafi 54), ku përcaktohet si në vijim: "*Sa i përket arsyeshmërisë së zgjatjes se procedurave,* [GJEDNJ] *thekson se kjo duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke pasur parasysh kriteret në vijim: ndërlikueshmëria e rastit, veprimet e parashtruesit të kërkesës dhe autoriteteve relevante, si dhe çfarë ishte në pyetje për parashtruesin në këtë mosmarrëveshje*".

98. Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës së saj, ka vlerësuar se përllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, të 23 prillit 1987, paragrafi 64, shih gjithashtu rastin *Poiss kundër Austrisë,* GJEDNJ, të 23 prillit 1987, paragrafi 50, dhe rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI 127/15, me parashtrues *Mile Vasovič,* Aktvendim për papranueshmëri i 15 qershorit 2015, paragrafi 43, KI 81/16, me parashtrues *Valdet Nikqi*, Aktgjykim i 31 majit 2017, KI19/17, Aktvendim për Papranueshmëri i 21 shkurtit 2018, paragrafi 50). Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit

(Shih rastin e GJEDNJ-së *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 74).

99. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kemi të bëjmë me procedurë përmbarimore, e cila është iniciuar nga parashtruesi i kërkesës më 4 prill 2014 dhe ka përfunduar me vendimin e kontestuar, më 17 maj 2019.

100. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata vëren se periudha të cilën duhet ta marrë në shqyrtim lidhur me pretendimet e parashtruesit për shkeljen e nenit 31.2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, është 5 (pesë) vite.

101. Për sa i përket ndërlikueshmërisë së rastit, Gjykata thekson se gjatë vlerësimit të pretendimit të palëve lidhur me tejzgjatjen e procedurave, ndërlikueshmëria e një procedure duhet të shqyrtohet në kuadër të aspektit faktik dhe juridik të kontestit në fjalë (shih rastin e Gjykatës, KI 19/17, parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 21 shkurtit 2018, paragrafi 56).

102. Gjykata thekson se në bazë të fakteve të elaboruara më lart, rasti i parashtruesit të kërkesës mund të konsiderohet si i ndërlikuar, në vështrim të gjendjes faktike dhe juridike. Në këtë sfond, Gjykata potencon se çështja thelbësore që ndërlikon zbatimin e procedurës përmbarimore në këtë rast është pikërisht kontesti lidhur me atë se a duhet të zbatohet kjo procedurë përmbarimore, në bazë të dokumentit përmbarimor të kontestuar (faturave).

103. Përkitazi me veprimet e palëve në procedurë, Gjykata thekson se, në dritën e praktikës gjyqësore të saj dhe të GJEDNJ, tejzgjatja e procedurës vlerësohet edhe nga veprimet e palëve të cilat marrin pjesë në procedurë (shih, *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së *Eckle kundër Gjermanisë*, Aktgjykimi i 15 korrikut 1982, paragrafi 82; shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI 19/17, parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 21 shkurtit 2018, paragrafi 62).

104. Lidhur me veprimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka qenë aktiv duke ndërmarrë shumë veprime procedurale, gjegjësisht duke ndjekur të gjithë hapat procedural të vënë në dispozicion nga ligjet në fuqi. Poashtu, edhe pala kundërshtare në procedurë, Kompania "Kujtesa Net" Sh.P.K., ka ndërmarrë veprime të shumta procedurale (sidomos përmes prapësimeve të aktvendimeve për përmbarim).

105. Lidhur me veprimet e organeve kompetente në procedurën e lartpërmendur, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta që nga momenti i vënies së tyre në lëvizje ishin aktive në gjykimin e çështjes, ku gjatë gjithë procedurës janë nxjerrë gjithsej nëntë vendime gjyqësore. Gjykata, në dritën e rrethanave të ndërlikuara të këtij rasti, duke marrë parasysh bazën ligjore komplekse, veprimet e shumta e palëve procedurale, interesat legjitime të tyre dhe mjetet ligjore të përdorura nga palët, si dhe faktin se gjykatat kanë nxjerrë gjithsej nëntë vendime gjyqësore në këtë rast, arrin në përfundimin se gjykatat e rregullta, që nga momenti i vënies në lëvizje në këtë rast, nuk ishin pasive. Pra, bazuar në shkresat e lëndës dhe në dritën e rrethanave të rastit, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta që nga momenti i vënies në lëvizje ishin aktive në gjykimin e çështjes dhe, rrjedhimisht, nuk kanë shkaktuar tejzgjatje të paarsyeshme të procedurës.

106. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se lidhur me pretendimin e parashtruesit për tejzgjatje të procedurës, parashtruesi nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk dëshmojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij këtë të drejtë kushtetuese.

Përfundim

107. Si përfundim, Gjykata konstaton se lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me cenimin e të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, nga ana e Gjykatës së Apelit, në ndërlidhje me pretendimin për paanshmërinë e gjykatës, Gjykata konstaton se i njëjti është i bazuar.

108. Në këtë pikë, duke mos u përgjigjur në kërkesën e parashtruesit për përjashtimin e gjyqtarit H.Sh., dhe në pretendimet për mungesën e paanshmërisë së këtij gjyqtari, Gjykata e Apelit ka shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së.

109. Lidhur me pretendimin e parashtruesit për tejzgjatje të procedurës, në dritën e kritereve të vëna nga praktika e GJEDNJ-së dhe të zbatuara edhe nga Gjykata Kushtetuese, përkitazi me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata gjen se ky pretendim i parashtruesit është i pambështetur. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka shkelje të parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 21.4 dhe 113 (7) të Kushtetutës, nenin 20, të Ligjit dhe rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 29 mars 2021, njëzëri

VENDOS

I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË KONSTATOJË se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2386/2018, i 17 majit 2019, është i pavlefshëm dhe se i njëjti kthehet në rigjykim;

IV. TË URDHËROJË Gjykatën e Apelit që ta informojë Gjykatën Kushtetuese sa më shpejt që është e mundur, por jo më larg se 6 (gjashtë) muaj, përkatësisht deri më 12 shtator 2021, lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate, në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës;

V. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pritje të respektimit të këtij urdhri;

VI. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VII. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

VIII. TË DEKLAROJË se ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI195/20, Parashtruesi i kërkesës: Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar "Monego", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP.nr. 42/2020, të 25 qershorit 2020

KI195/20, Aktgjykim, vendosur më 29 mars 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, person juridik, institucion financiar jo-bankar, aplikimi qartazi i gabuar apo arbitrar i ligjit, vendim i arsyetuar gjyqësor, kërkesë e pranueshme, në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me revokimin e licencës së parashtruesit të kërkesës si institucion financiar jo-bankar, nga ana e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) përmes Vendimit [Nr.77-32/2019] të 6 dhjetorit 2019. Revokimi i licencës nga ana e BQK-së mbështetej në arsyetimin se parashtruesi i kërkesës ka aplikuar norma efektive të interesit për kredi dukshëm më të larta se norma efektive e paraqitur në planin e biznesit të paraqitur në BQK.

Kundër Vendimit të BQK-së, parashtruesi i kërkesës në procedurë administrative kishte parashtruar kërkesëpadi për anulimin e vendimit dhe të njëjtën kohë në bazë të paragrafëve 2 dhe 6 të nenit 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) kishte paraqitur edhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së. Gjykata Themelore kishte refuzuar kërkesën e tij për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit duke aplikuar kriteret e paragrafëve 2 dhe 6 të nenit 22 të LKA-së, në të cilin rast kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dëshmuar se (i) ekzekutimi i Vendimit deri në vendosjen e meritave të rastit para gjykatave atij do t'i sillte dëm të madh dhe të paripareushëm dhe se (ii) shtyrja e ekzekutimit të Vendimit nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik. Si rezultat i ankesës së tij ndaj Aktvendimit të dytë A.nr. 3029/2019 , të 3 shkurtit 2020 të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit kishte vërtetuar konstatimin e Gjykatës Themelore përkitazi me mospërmbushjen e kritereve të nenit 22 të LKA-së për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së, dhe duke shtuar aplikimin edhe të nenit 76 të Ligjit për BQK-në kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në fund, pas kërkesës së parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, gjegjësisht Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, të parashtruar në Gjykatën Supreme, kjo e fundit refuzoi kërkesën e tij si të pabazuar dhe vërtetoi konstatimin e Gjykatës së Apelit.

Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e Gjykatës Supreme duke pretenduar shkelje të nenit 31, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; nenin 32

[E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së; si dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; dhe nenet 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së. Në esencë, për pretendimin për shkeljen e së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesi i kërkesës ankohet për aplikueshmërinë e nenit 76 të Ligjit për BQK-në, nga ana e gjykatave të rregullta duke theksuar se këto të fundit (i) kanë aplikuar në mënyrë qartazi të gabuar nenin 76 të Ligjit për BQK-në; dhe (ii) nuk kanë arsyetuar vendimet e tyre.

Gjykata gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës konstatoi se parashtruesi i kërkesës (i) është palë e autorizuar, sepse e dorëzoi kërkesën në cilësinë e personit juridik me qëllim të mbrojtjes së të drejtave, të garantuar me Kushtetutë; (ii) ka saktësuar të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë për të cilat pretendon se i janë shkelur; (iii) ka dorëzuar kërkesën e tij brenda afatit; (iv) marrë për bazë faktit që objekt i çështjes është vlerësim i vendimeve të gjykatave të rregullta, të nxjerra në procedurë paraprake, Gjykata duke aplikuar kriteret e përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, të mbështetur në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) konstatoi se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është i aplikueshëm në rastin e tij; dhe rrjedhimisht përfundoi se (v) se kërkesa e parashtruesit të kërkesës gjithashtu plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafi (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Gjykata, pas vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar edhe standardet e praktikës gjyqësore të vet Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së konkludoi si në vijim:

Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta theksoi se baza e shqyrtimit të kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit të BQK-së, pranë Gjykatës Themelore ishte neni 22 i LKA-së, paragrafët 2 dhe 6. Rrjedhimisht, Gjykata konsideroi se konstatimet dhe konkluzionet e gjykatave të rregullta nuk janë arbitrare sepse në këtë procedurë paraprake mbështeten në radhë të parë në vlerësimin e tyre për plotësim të kritereve të përcaktuar në nenin 22, paragrafëve 2 dhe 6 të LKA-së dhe rrjedhimisht referimi edhe i nenit 76 të Ligjit për BQK-në nga Gjykata e Apelit, nuk e ka penguar këtë gjykatë dhe më pas edhe Gjykatën Supreme të konstatojë se nuk janë plotësuar kriteret e përcaktuar me nenin 22 të LKA-së për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit.

Së dyti, përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm , si rezultat i mos-

arsyetimin të vendimit gjyqësor, Gjykata theksoi se bazuar në rrethanat e rastit konkret, shqyrtimi apo aprovimi i pretendimit të parashtruesit të kërkesës për aplikim të gabuar të nenit 76 të Ligjit për BQK-në si të bazuar, nuk do ta ndërronte rezultatin në rastin e tij dhe kjo për faktin se, objekt shqyrtimi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës në procedurën paraprake para gjykatave të rregullta ishte shtyrja e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së dhe vlerësimi nga këto të fundit nëse ishin plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 22 të LKA-së.

Si përfundim, Gjykata, përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për (i) shkak të aplikimit të gabuar të ligjit dhe (ii) mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata konstaton se Aktgjykimi i kontestuar ARJ-UZVP.nr. 42/2020, i 25 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme nuk përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, nenit 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së; dhe nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenet 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së, Gjykata të njëjtat i konsideroi se të njëjtat parashtruesi i kërkesës i ndërlidh me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, rrjedhimisht Gjykata të njëjtat i konstatoi si qartazi të pabazuara në baza Kushtetuese ashtu siç përcaktohet me nenin 39 (2) të Rregullores së punës.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI195/20

Parashtrues

Aigars Kesengfelds,
pronar i institucionit financiar jo-bankar "Monego"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
ARJ-UZVP.nr. 42/2020, të 25 qershorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar "Monego" me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqësojnë avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi, nga Shoqëria e Avokatëve "Koci & Vokshi", Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr. 42/2020, të 25 qershorit 2020 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme).

3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 6 tetor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ); nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së; si dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenet 7, 8 dhe 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 7 të nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 30 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 8 janar 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

8. Më 12 janar 2021, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës, dhe Gjykata kërkoi nga ai që të nënshkruajë formularin e kërkesës, dhe të bashkëngjisë Vendimin Nr.77-32/2019 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: BQK). Në po të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme dhe BQK-së. Kësaj të fundit iu dha mundësia t'i paraqesë komentet e saj

në lidhje me kërkesën, nëse ka. Gjykata gjithashtu njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamentin Administrativ (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që kjo e fundit të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën e cila dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

9. Më 14 janar 2021, Gjykata Themelore dorëzoi fletëkthesën në Gjykatë, e cila dëshmon se parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 6 tetor 2020.

10. Më 22 janar 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë dokumentacionin e kërkuar.

11. Më 25 janar 2021, BQK, i dorëzoi në Gjykatë komentet e saj lidhur me rastin. Për këto komente, u njoftua edhe parashtruesi i kërkesës.

12. Më 29 mars 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri konstatoi se (i) kërkesa e parashtruesit është e pranueshme; dhe se (ii) Aktgjykimi ARJ-UZVP.nr. 42/2020, i 25 qershorit 2020 i Gjykatës Supreme është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 26 shkurt 2018, BQK përmes licencës së saj [nr. 07 – 04/2018] e regjistroi parashtruesin e kërkesës si institucion financiar jo-bankar që të ushtrojë veprimtarinë financiare të dhënies së kredive.

14. Më 6 dhjetor 2019, BQK përmes Vendimit Nr.77-32/2019 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i BQK-së) duke konstatuar se parashtruesi i kërkesës "nga *fillimi i operimit, IFJB Monego ka aplikuar norma efektive të interesit për kredi dukshëm më të larta se sa norma efektive e paraqitur në planin e biznesit dërguar në BQK, konform së cilës është regjistruar si institucion financiar jo bankar. [...]"* vendosi: (i) të revokojë licencën [nr. 07 – 04/2018] për regjistrimin e parashtruesit të kërkesës si institucion financiar jo-bankar; (ii) të hapen procedurat e likuidimit bazuar në Ligjin Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Bankat); dhe (iii) caktoi V.Z. si likuidator.

15. BQK, Vendimin e saj për revokimin e licencës ndaj parashtruesit të kërkesës për ushtrimin e veprimtarisë si institucion financiar jo-bankar e arsyetoi si në vijim:

[...]

"Në përcjellje të zbatimit të vendimit Nr. 16 - (07/2019) është kryer ekzaminimi i fokusuar në këtë institucion. Nga ky ekzaminim në IFBJ Monego është konstatuar se IFBJ Monego ka bërë ulje të pjesshme të normave të interesit krahasuar me planin e biznesit të dorëzuar në BQK me rastin e regjistrimit ku kishte planifikuar që norma efektive e interesit të jetë 26. 8 %. Bazuar në mostrën e përzgjedhur për ekzaminim është vërtetuar se kredia me normë efektive më të ulët, duke përjashtuar ato pa interes është 81.05 % ndërsa më e larta 332. 97 % duke përfshirë tarifën për shpërndarjen e mjeteve të kredisë në para të gatshme i cili si shërbim ofrohet me mundësi zgjedhjeje dhe si i tillë nuk duhet të përfshihet në përllogaritjen e normës efektive të interesit. Pas rikalkulimeve të normës efektive të interes ku është përjashtuar tarifa për shpërndarjen e mjeteve të kredisë në para të gatshme është arritur në përfundim se kredia me normën efektive më të ulët, duke përjashtuar ato pa interes, është 81.05% ndërsa më e larta 236.20%.

Në zbatim të Rregullores së BQK për procedurat e shqiptimit të Ndëshkimeve Administrative lidhur me ekzaminimin e realizuar nga data 05-09 shtator 2019, BQK me datë 27 shtator 2019 I ka dërguar IFBJ Monego Njoftimin për Qëllimin e Shqiptimit të Masës Ndëshkimore Administrativ, ku përmes këshillës juridike është informuar për të drejtën e saj për të bërë kërkesë për rishqyrtimin te Divizioni për Rishqyrtim në BQK, Brenda afatit prej 15 ditëve nga data e pranimit Të njoftimit. Më 15 tetor 2019, IFBJ Monego ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të Njoftimit për qëllim të shqiptimit të Masave Ndëshkimore administrative Në Divizionin për Rishqyrtim pranë BQK-së.

Divizioni i Rishqyrtimit e ka shqyrtuar kërkesën në pajtim me Rregulloren për Procedurat e Shqiptimit të Masës Ndëshkimore Administrative dhe pasi ka administruar të gjitha provat që kishte në dispozicion ka konstatuar se shkeljet e evidentuara gjatë ekzaminimit qëndrojnë dhe sit ë tilla këto shkelje janë adresuar drejtë në Njoftimin për qëllimin e shqiptimit të masave

ndëshkimore administrative, andaj mbi këtë bazë kërkesën për rishqyrtim të IFJB Monego e ka vlerësuar si të pabazuar."

16. Më 17 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi pranë Gjykatës Themelore me kërkesën që Vendimi i BQK-së të anulohet. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se kërkesa e parashtruesit për anulimin e Vendimit të BQK-së është akoma në procedurë të shqyrtimit para gjykatave të rregullta.

17. Po më 17 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore parashtroi kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së Nr.77-32/2019.

18. Parashtruesi i kërkesës, kërkesën e tij për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit të BQK-së, e kishte parashtruar në bazë të nenit 22, paragrafët 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (në tekstin e mëtejmë: LKA). Në kontekst të plotësimit të kritereve në bazë të paragrafit 2, të nenit 22 të LKA-së, theksoi se ai do *"të pësoj dëm të madh dhe të pariparueshëm në rast se Gjykata nuk merr vendim për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit Nr. 77-32/2019 të Bankës Qendrore të Kosovës."* Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar nenit 71 dhe nenit 73 të Ligjit për BQK-në, të cilat dispozita i referohen procedurës së likuidimit, arsyetoi se *"Likuidatori i merr përsipër të gjitha opercaionet e Monego dhe e zhvesh aksionarin nga çdo e drejtë e tij."* Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës arsyetoi se "*Ashtu siç e përcakton Ligji për Bankat, likuidimi pritet të përfundohet brenda një periudhe prej afërsisht një vjeçare, [...] dhe Monego do të pushoj së ekzistuari*".

19. Në kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së, parashtruesi i kërkesës duke iu referuar nenit 22, paragrafëve 2 dhe 6 të LKA-së, theksoi se vendimi i BQK-së i shkakton atij: (i) dëm të madh e të pariparueshëm; dhe se (ii) shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik. Sa i përket pikës (i), gjegjësisht çështjes së dëmit të madh e të pariparueshëm, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera kishte theksuar se ai përveç dëmit real, do pësojë edhe dëm për shkak të fitimit të humbur. Në këtë pikë parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij për shtyrje të ekzekutimit të vendimit u ishte referuar dhe Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI122/17 me parashtrues të kërkesës *Česká Exportní Banka A.S.* [Aktgjykim i 18 prillit 2018], duke theksuar, ndër të tjera se masat e përkohshme bazuar në nenin 6 të KEDNJ-së janë kategori kushtetuese, dhe nëse gjykata nuk vendosë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, atij do t'i shkelet e drejta e tij në pronë. Ndërsa, sa i përket pikës (ii) se shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik,

parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se kompania e tij u kishte shërbyer më shumë se 80.000 personave, i cili fakt sipas tij nënkupton se qytetarët kanë nevojë për shërbimet e ofruara nga ai. Parashtruesi i kërkesës po ashtu theksoi se pjesëmarrja e tij në tregun e kredive nuk paraqet formë të rrezikut për stabilitetin financiar të vendit dhe se interesi publik do të cenohej më shumë në rast se mbetet në fuqi Vendimi i BQK-së. Këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës e arsyeton edhe me faktin se dyqind e pesëdhjetë (250) punonjës, të punësuar në këtë institucion me efekt të menjëhershëm do të mbeten pa punë.

20. Më 20 dhjetor 2019, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit A.nr. 3029/2019, refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së si të pabazuar. Gjykata Themelore duke iu referuar nenit 22, paragrafëve 2 dhe 6 të LKA-së vlerësoi se: (i) parashtruesi i kërkesës nuk e ka bërë të besueshme me provat që gjenden në shkresat e lëndës se Vendimi i BQK-së do t'i shkaktojë dëm i cili vështirë do të riparohej; dhe (ii) se shtyrja e ekzekutimit të të njëjtit Vendim nuk është në interes publik.

21. Më 30 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit A.nr. 3029/2019, të 20 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) me pretendimin për (i) shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore me arsyetimin se Gjykata Themelore nuk ka bërë analizimin e provave dhe arsyetimi i vendimit është në kundërshtim me përmbajtjen e shkresave të lëndës. Në këtë aspekt parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 106 të Ligjit Nr. 03 L/-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK) i cili sipas tij përcakton se çka duhet të përmbajë një Aktvendim; dhe (ii) konstatim të gabuar të gjendjes faktike, për shkak të vlerësimit të gabuar të provave. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij sërish theksoi se atij do t'i shkaktohet dëm i madh dhe i pariparueshëm, për shkak të hapjes së procedurës së likuidimit, me ç'rast parashtruesi i kërkesës *"zhveshet nga çdo e drejtë e tij"*. Parashtruesi i kërkesës, në ankesën e tij i referohet edhe praktikës gjyqësore përkitazi me vendosjen e masave të përkohshme, përkatësisht rastit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), *Micallef kundër Maltës,* dhe në këtë kontekst thekson se duke qenë se Gjykata Themelore është e ngarkuar, dhe lënda e tij nuk pritet të zgjidhet edhe së paku tri (3) vite, ai do të pësonte dëm të pariparueshëm sepse *"Monego do të pushonte së ekzistuari"*.

22. Më 24 janar 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit AA. Nr. 48/2020, aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të bazuar, dhe

anuloi Aktvendimin e Gjykatës Themelore A.nr. 3029/2019, të 20 dhjetorit 2019 duke e kthyer lëndën në rivendosje.

23. Gjykata e Apelit arsyetoi se Aktvendimi i Gjykatës Themelore A.nr. 3029/2019, i 20 dhjetorit 2019, është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së, gjegjësisht *"nga neni 182 par.2 nënpar. n) dhe nga neni 183 të LPK-së, të aplikueshme sipas nenit 63 të LKA-së"* sepse i njëjti është juridikisht i paqartë, kundërthënës, dhe është jo i plotë edhe në vërtetim të gjendjes faktike. Gjykata e Apelit më tej arsyetoi se *"Për shkak të qëndrimit të gabuar juridik dhe mos arsyetimit të aktvendimit të ankimuar, masa e përkohshme e propozuar, nuk guxon të përfshijë kërkesëpadinë, gjykata e shkallës së parë ka lëshuar të vlerësoj theksimet e paditësit se a janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për miratimin e masës së përkohshme të propozuar"*. Gjithashtu, Gjykata e Apelit, theksoi se *"gjykata e shkallës së parë duhet të veproj si në kuptim të nenit 305 par.1 dhe 2 të LPK-së, të aplikueshëm me nenin 63 të LKA-së, që kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar bashkë me shkresat e lëndës t'ia dërgon të paditurës me njoftim se mund të paraqesë përgjigje brenda afatit ligjor, e cila është parakusht."* Në fund, Gjykata e Apelit theksoi që gjykata e shkallës së parë duhet të kufizohet në konstatimin e të provuarit të bazueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, në kuptim të nenit 22 paragrafin 2 të LKA-së, dhe a janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet.

24. Më 3 shkurt 2020, Gjykata Themelore, në procedurën e rivendosjes, përmes Aktvendimit A.nr. 3029/2019, refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së si të pabazuar. Sa i përket çështjes për aplikueshmërinë e LPK-së, Gjykata Themelore theksoi se i njëjti ligj nuk mund të aplikohet, për faktin se sipas nenit 63 të LKA-së, neni 305 i LPK-së mund të aplikohet vetëm nëse nuk përmban dispozita për procedurën e konfliktit administrativ. Gjykata Themelore duke iu referuar nenit 22, paragrafëve 2 dhe 6 të LKA-së arsyetoi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka bërë të besueshme me provat që gjenden në shkresat e lëndës, se Vendimi i BQK-së (i) do t'i shkaktojë dëm i cili vështirë do të riparohej dhe se (ii) shtyrja nuk është në interes publik apo që shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm palës kundërshtare.

25. Më 12 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës fillimisht theksoi se LKA nuk parasheh dispozitë të veçantë lidhur me procedurën e nxjerrjes apo ankimimit të aktvendimeve me anë të cilave refuzohen apo aprovohen kërkesat për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij

thekson *"në mungesë të dispozitave specifike që rregullojnë këtë çështje, LKA në nenin 63 parasheh se nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore."* Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës sa i përket pretendimeve për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore, iu referua nenit 182, paragrafi 1 të LPK-së në lidhje me nenin 8, paragrafi 2 si dhe nenin 160, paragrafët 4 dhe 5 të LPK-së, dhe nenin 182 paragrafi 2 pika n) me pretendimin se *"gjykata nuk e ka bërë fare analizimin e provave [...]". Tutje,* sipas parashtruesit të kërkesës, edhe pse LKA nuk parasheh ndonjë dispozitë të veçantë e cila përcakton se çka duhet të përmbajë aktvendimi me anë të cilit pranohen apo refuzohen kërkesat për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve, neni 63 i LKA-së është i aplikueshëm në rastin e tij.

26. Më 26 shkurt 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit AA. Nr. 164/2020, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.

27. Gjykata e Apelit fillimisht gjeti *"se gjykata e shkalles së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrje e ekzekutimit te Vendimit te BQK-se me numër Nr.77- 32/2019 të datës 06.12.2019, ka gjetur se propozimi i tille është i pabazuar, ngase paditësi nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë të vetme pretendimin e tij, se me ekzekutimin e vendimit të paditurit, i njëjti do t'i sillte dem i cili vështirë do të riparohej dhe se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kusht ky ligjor i cili duhet të provohet nga paditësi, për të shtyre pastaj gjykata ekzekutimin e Vendimit të kontestuar. Andaj, gjykata gjatë vlerësimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të kontestuar, iu ka referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par.2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktin Administrativ".*

28. Gjykata e Apelit, më tej përmes Aktgjykimit të saj "vlerëso[i] *se ankesa e [parashtruesit të kërkesës] është në tërësi e pa bazuar. E gjithë kjo për arsye se me Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës është përcaktuar Imuniteti ndaj caktimit të masës së përkohshme gjyqësore, ndaj të paditurës ngase me nenin 76 të të njëjtit ligj përcaktohet se* "1. *Asnjë ndalesë apo ekzekutim nuk mund të shqiptohet ndaj Bankës Qendrore apo pronës se saj, duke përfshirë arin, të drejtat e veçanta të tërheqjes, paratë e gatshme, paratë në llogari, depozitat ose letrat me vlerë, dhe çdo të ardhur nga to, para shqiptimit të vendimit përfundimtar në çdo veprim ligjor të parashtruar para gjykatave te Kosovës.* 2. *Banka Qendrore mundet,*

plotësisht ose pjesërisht, të heqë dore nga çdo mbrojtje, në mënyrë të qarte dhe me shkrim, me përjashtim të arit dhe të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes që mbahen në llogarinë e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar". Në kontekst të kësaj, Gjykata e Apelit konstatoi se *"Në rastin konkret propozuesi-paditësi me ankesën e ushtruar kërkon që të shtyhet ekzekutimi i vendimit Nr.77-32/2019 të datës 06.12.2019, të Bankës Qendrore të Kosovës për Revokimin e regjistrimit të Institucionit Financiar bankar "Monego" deri ne marrjen e vendimit gjyqësor. Andaj duke u bazuar ne dispozitën e lartcekur në procedure gjyqësore ndaj të paditurës [Bankës Qendrore] nuk mund të shqiptohet asnjë masë e sigurisë në raport me aktivitetin e cekur si në dispozitën më lartë".*

29. Në vijim Gjykata e Apelit theksoi se *"Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se, Gjykata Themelore në Prishtine-Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të BQK, mirëpo për të mbështetur këtë qëndrim juridik të shkallës së parë, kjo gjendje faktike bazohet edhe në nenin 76 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe se nuk është cenuar ligji në dem të paditësit me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkalles së parë me rastin e marrjes së aktvendimit nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura, dhe se nuk i ka konstatuar fare faktet e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkalles së parë, edhe pse i ka munguar arsyetimi dhe dispozita ligjore konkrete materiale e cekur me lartë, kjo nuk ka ndikuar në vendosjen ndryshe të kësaj çështje andaj aktvendimi i ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm".*

30. Më 19 mars 2020, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Supreme parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, respektivisht Aktvendimit AA. Nr. 164/2020 të Gjykatës së Apelit. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit pretendoi (i) zbatim të gabuar të së drejtës materiale; (ii) se ekzekutimi i Vendimit të BQK-së do t'i shkaktonte atij dëm të madh dhe të pariparueshëm; dhe se (iii) shtyrja e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së nuk është në kundërshtim me interesin publik.

31. Së pari, në lidhje me pretendimin e tij për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, parashtruesi i kërkesës specifikoi se Gjykata e Apelit në mënyrë të gabuar ka zbatuar nenin 76 të Ligjit për BQK-në duke theksuar se *"Një interpretim i tillë i kësaj dispozite është tërësisht i gabuar dhe nuk përkon as me frymën e Ligjit për BQK-në si tërësi, e as më përmbajtjen e dispozitës në fjalë në veçanti"* duke vazhduar se nga leximi kësaj dispozite "[...] *ndalesat dhe ekzekutimet në fjalë nuk mund të shqiptohen ndaj BQK-së dhe aseteve të saj, kurse në rastin konkret kërkesa për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit është propozuar të drejtohet ndaj procesit të likuidimit të Monego pra që ky proces të ndalohet deri në marrjen e vendimit përfundimtar."* Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës në vijim specifikoi se përmes Aktvendimit të Gjykatës së Apelit është ngatërruar objekti i çështjes, gjegjësisht sipas tij *"Neni 76 i Ligjit për BQK-në vije në shprehje në raste kur ndaj Republikës së Kosovës apo ndaj BQK-së ekzistojnë pretendime nga palë të treta dhe mbi asetet e këtyre të fundit propozohet të vendoset masa e përkohshme."* Parashtruesi kërkesës, në vijim arsyeton se zbatimi i nenit 76 të Ligjit për BQK-në sipas tij nënkupton se Vendimet e BQK-së nuk mund t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor e që është në kundërshtim me nenin 54 të Kushtetutës.

32. Së dyti, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij po ashtu arsyetoi se Vendimi i BQK-së atij do t'i shkaktonte dëm të madh dhe të pariparueshëm, gjegjësisht ai do të pësonte dëme të mëdha në kuptim të dëmit material, por edhe dëm në kuptim të fitimit të humbur. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të së drejtës së tij në pronë.

33. Së treti, parashtruesi i kërkesës arsyetoi se shtyrja e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së nuk është në kundërshtim me interesin publik. Në kontekst të kësaj të fundit, parashtruesi i kërkesës specifikon se (i) institucioni i tij financiar i ka shërbyer më shumë se 80, 000 personave; (ii) personave që nuk kanë llogari në Kosovë, i jep qasje në mjete financiare; (iii) pjesëmarrja e tij në tregun financiar *"nuk paraqet asnjë formë të rrezikut për stabilitetin financiar të vendit";* (iii) për faktin se ky institucion nuk mund të mbajë depozita për kreditë e dhëna në këtë mënyrë nuk shfrytëzohen dhe rrezikohen paratë e qytetarëve ashtu siç kjo bëhet nga bankat klasike; dhe (iv) mbetja në fuqi e Vendimit të BQK-së do të shkaktonte humbjen e punës të më shumë se dyqind e pesëdhjetë punonjësve, të punësuar në këtë institucion.

34. Më 25 qershor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit ARJ-UZVP. 42/2020, refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktvendimit AA. Nr. 164/2020, të 19 marsit 2020, të Gjykatës së Apelit si të pabazuar.

35. Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e saj, së pari duke iu referuar paragrafëve 2 dhe 6 të nenit 22 të LKA-së theksoi se *"kjo dispozitë përcakton se shtyrja mund të bëhet me kërkesën e paditësit, organi, akti i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutimin, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrative do t'i sillte dem paditësit, i cili vështire do te riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik e as qe shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit te interesuar. Ndërsa me dispozitën e nenit 22.6 të të njëjtit ligj përcaktohet se paditësi mund të kërkoj nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit te aktit administrativ deri ne marrjen e vendimit gjyqësor , sipas kushteve te parapare me nenin 22 par.2 te LKA-së".*

36. Së dyti Gjykata Supreme theksoi se *"Përveç kësaj, neni 76 i Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës përcakton imunitetin ndaj caktimit të masës së përkohshme gjyqësore, respektivisht asnjë ndalese apo ekzekutim nuk mund të shqiptohet ndaj Bankës Qendrore apo pronës së saj".*

37. Në fund, Gjykata Supreme gjeti se *"[...] gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejtë duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe duke e vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë me të cilin është refuzuar propozimi i paditësit. Kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit, dispozitat e procedurës administrative, ato të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Janë të pabazuara thëniet e paditësit lidhur me shkeljet, ngase vendimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm. Arsyetimi i aktvendimit të goditur përmban arsye të mjaftueshme dhe fakte vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu kjo Gjykatë vlerëson se është bërë aplikim i drejtë i së drejtës materiale dhe nuk është shkel ligji në dëm të paditësit".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesi i kërkesës, pretendon se përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; nenin 32 [E Drejta për Mjete

Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 (e drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së; si dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; dhe nenet 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së.

Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

39. Përkitazi me aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, parashtruesi i kërkesës duke iu referuar Aktgjykimit të GJEDNJ në rastin *Micallef kundër Maltës* (Aktgjykim, i 30 prillit 2018) konsideron se ky nen është i aplikueshëm në rastin e tij. Në lidhje me këtë, dhe përkitazi me plotësimin e kritereve të përcaktuara në Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Micallef*, parashtruesi i kërkesës sqaron se *"Licenca me të cilën [ai] ka disponuar përbën një të drejtë civile" në formën e autorizimit për të ndërmarrë veprime të caktuara në domenin e institucioneve financiare - për vet faktin se licenca - e cila përbën një të drejtë - mund te revokohet."* Në vijim, parashtruesi i kërkesës përkitazi me "karakterin civil" të së drejtës së cenuar specifikon se *" [...] revokimi i licencës si dhe fillimi i procedurave të likuidimit ka pasur një ndikim të qarte dhe vendimtar lidhur me te drejtën e [e tij] për të menaxhuar çështjet e tij financiare si dhe të administroje me pronën e tij"*.

40. Parashtruesi i kërkesës konkludon se "*Fakti që institucionet financiare janë entitete ligjore si dhe fakti që industria bankare është një industri e rregulluar në mënyre të detajuar - si pasojë e rëndësisë së saj vitale -nuk është arsye e mjaftueshme për të konkluduar se procedurat të cilat përfshijnë institucionet financiare - nuk bien në domenin e Nenit 32 të Kushtetutës dhe Nenit 6 te KEDNJ (shih, mutatis mutandis, Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut te 24 shkurtit 2006, Capital Bank AD kundër Bullgarisë, Nr. 49429/99, paragrafët 86-87).* Rrjedhimisht, parashtruesi konsideron se *"Neni 31 i Kushtetutës dhe Neni 6 i KEDNJ gjejnë aplikim ne rastin konkret"*.

41. Parashtruesi i kërkesës thekson se LKA ofron mundësi ligjore për atakimin e vendimeve administrative me anë të padisë për konflikt administrativ, ankesave ndaj akteve administrative si dhe kundërshtimeve në rastet e përcaktuara me ligj. Në këtë pikë, parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 22, paragrafëve 2 dhe 6 të LKA-së, duke theksuar se funksioni kryesor i kërkesës për shtyrjen e

ekzekutimit të vendimit është parandalimi i shkaktimit të dëmit ndaj parashtruesit të kësaj kërkese.

42. Parashtruesi i kërkesës specifikon se *"Në rastin aktual, Gjykata Supreme duke u mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore [...] ka interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën e Nenit 76 të këtij ligji - duke e zbatuar të njëjtën në mënyrë arbitrare"*.

43. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës specifikon se *"Zbatimi i gabuar si te drejtës materiale nga ana e Gjykatës Supreme konsiston ne dy drejtime: (a) trajtimi i kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit te vendimit nga Neni 22, paragrafi 6 te Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Masës se Përkohshme nga Neni 76 i Ligjit për Bankën Qendrore - si te njëjta apo të zëvendësueshme; dhe (b) përfundimi i gabuar për subjektin ndaj te cilit është drejtuar kërkesa për shtyerjen e ekzekutimit te vendimit. Fillimisht, duhet te theksohet se Gjykata Supreme - duke bere leximin tekstual te titullit te dispozitës se Nenit 76 të Ligjit për Bankën Qendrore - i barazon si për nga efekti, ashtu edhe për nga karakteristikat ligjore Kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nga Neni 22, paragrafi 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative si dhe Masën e Përkohshme nga Neni 76 i Ligjit për Bankën Qendrore - mase kjo e cila shikuar në bazën e saj mund të ndërlidhet vetëm me Masën e përkohshme të sigurisë nga Neni 306 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore"*.

44. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon se këto dy mjete juridike, dallojnë për nga substanca për shkak se sipas tij LKA parasheh kushtet për aprovimin e kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit por nuk parasheh nocionin e masës së përkohshme. Parashtruesi i kërkesës specifikon se "*masa e përkohshme për të cilin flet Ligji për Bankën Qendrore, nuk është dhe nuk mund të konsiderohet e njëjtë apo e ngjashme me Kërkesën për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit-por vetëm me masën e përkohshme sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore"*.

45. Parashtruesi i kërkesës thekson se neni 76 i Ligjit për BQK-në, nuk i jep imunitet kësaj të fundit ndaj kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, por vetëm ndaj masës së përkohshme, dhe sipas parashtruesit të kërkesës "ndalesat" dhe "ekzekutimet" që përmenden në nenin 76 i atribuohen BQK-së dhe pronës së saj dhe si të tilla i takojnë fushës kontestimore dhe asaj përmbarimore, dhe në asnjë mënyrë asaj administrative. Parashtruesi i kërkesës lidhur me këtë pikë argumenton se "ndalesat" i referohen neneve 297, 299, 300, 301 dhe 306 të LPK-së, ndërsa "ekzekutimi" nënkupton inicimin e procedurës përmbarimore, sipas nenit 4 të Ligjit Nr.04/L-139 për

Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejmë: LPP). Parashtruesi i kërkesës, në vijim pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur ligjin material sepse konstatimi i kësaj të fundit i është atribuuar subjektit të gabuar për faktin se neni 76 i atribuohet BQK-së, e jo parashtruesit të kërkesës.

46. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ka plotësuar kriteret e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, sepse është vendim i paarsyetuar, sepse nuk ka adresuar thëniet dhe argumentet e parashtruesit të kërkesës. Në kontekst të pretendimit të tij për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës rithekson se meqenëse LKA nuk parasheh se çka duhet të përmbajë Aktgjykimi me të cilat refuzohen apo miratohen kërkesat për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve, në mungesë të dispozitave të tilla aplikohet neni 63 i LKA-së, e që rrjedhimisht do duhej aplikuar neni 160 i LPK-së i cili përcakton se çka duhet të përmbajë Aktgjykimi.

47. Parashtruesi i kërkesës, më tej po ashtu specifikon se: "*Rrjedhimisht, Gjykata Supreme ne asnjë moment nuk e ka marre mundin për të argumentuar asnjë nga faktet vendimtare - por vetëm është kufizuar ne një arsyetim të vobekët kundërligjor*. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës i referohet dhe citon rastin e GJEDNJ-së *Oleynikov kundër Rusisë*, në të cilin rast ishte theksuar se "*Për më tepër, nuk do të ishte në përputhje me sundimin e ligjit në një shoqëri demokratike si dhe në përputhje me Nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së - që pretendimet civile të jenë të mundshme të parashtrohen para një gjyqtari për gjykim - nëse një shtet do të kishte mundësinë që pa kufizime apo kontroll të organeve zbatuese të konventës, që të largojnë nga juridiksioni i tyre një gamë të gjerë pretendimesh civile apo t'i jap imunitet nga përgjegjësia dikujt* [kërkesa nr. 36703/04, paragrafi 65]". Në vijim, parashtruesi i kërkesës po ashtu i referohet dhe citon rastin *Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar*, në të cilin rast GJEDNJ kishte theksuar se: *" Kësisoj, në rastet kur aplikimi i dispozitave të imunitetit shtetëror kufizon ushtrimin e të drejtës për qasje në gjykatë - gjykata duhet të përcaktojë nëse rrethanat e rastit e arsyetojnë një kufizim të tillë"* [kërkesa nr. 17101/90, paragrafi 59]. Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës pohon se *"Megjithatë, Gjykata Supreme nuk ka e ka trajtuar fare parimin e proporcionalitetit nëse rrethanat e rastit e arsyetojnë një kufizim të tillë"*.

48. Në kontekst të pretendimit për mos arsyetim të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe rastit KI72/12 të Gjykatës me parashtrues *Veton Berisha* [Aktgjykim, i 17 dhjetorit 2012].

49. Parashtruesi i kërkesës rithekson se deri në momentin kur të merret vendim meritor nga gjykatat e rregullta, ky vendim do të jetë i pavlerë sepse sipas tij *"dëmi tanimë do të ishte i paripërueshëm-për arsye se Monego do të pushonte së ekzistuari. Andaj, vendimi për kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të BQK-së është vendimtar për mbrojtjen e të drejtave të [parashtruesit të kërkesës]".*

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së

50. Parashtruesi i kërkesës duke iu referuar rastit të GJEDNJ-së *Aksoy kundër Turqisë* [Aktgjykim, i 31 tetorit 2006], pretendon se mjeti juridik në rastin e tij, është joefektiv si pasojë e mostrajtimit të meritave të rastit. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës thekson se legjislacioni në fuqi ka paraparë kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit si mjet të qasshëm me ligj, i cili sipas tij është vërtetuar të jetë joefektiv në praktikë, si rezultat i interpretimit flagrant nga Gjykata Supreme.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

51. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në rastin e tij ekziston pritja legjitime sepse sipas tij *"pajisja me licencë-për të ushtruar këtë veprimtari ekonomike sipas kushteve ligjore të përcaktuara (sipas kritereve të parapara me legjislacionin relevant për Bankat) përbën aset në kuptimin e pasurisë që rrjedh nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike në sektorin financiar [...]". Në këtë kontekst,* parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të GJEDNJ-së *Tre Traktorer AB [Aktgjykim, i 7 korrikut 1989] duke theksuar se interesat ekonomike që rrjedhin nga drejtimi i një biznesi paraqesin pronë apo aset.*

52. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se GJEDNJ në rastin *Lonnroth kundër Suedisë* [Aktgjykim, i 13 shtatorit 1982], ka përcaktuar tri parime specifike: *"(i) Parim i përgjithshëm i ushtrimit të papenguar të së drejtës së pronësisë; (ii) rregulli se çdo privim nga e drejta në pronë duhet të kryhet sipas kushteve të caktuara [...] (iii) parimi që shteti mund ta kontrollojë përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm nëpërmjet miratimit/zbatimit të ligjeve që shihen si të nevojshme për të arritur qëllimet e parapara[...]."* Prandaj, parashtruesi i kërkesës thekson se tri parimet bazë në rastet e kufizimit janë në (i) Parimi i ligjshmërisë; (ii) Parimi i ekzistimit të qëllimit legjitim në mbrojtjen e interesit publik; dhe (iii) Parimi i Proporcionalitetit.

53. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu citon rastin e GJEDNJ-së *Capitol Bank AD kundër Bullgarisë* [Aktgjykim, i 24 nëntorit 2005] dhe pohon se parimi i ligjshmërisë, supozon, që ligji vendor duhet të ofrojë mekanizëm për mbrojtje kundër interferimeve arbitrare nga ana e autoriteteve publike. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës, thekson se rastin e tij, ai këtë nuk ka mundur të prezantojë para gjykatave të rregullta për arsye se Gjykata Supreme në mënyrë të gabuar ka interpretuar nenin 76 të Ligjit për BQK-në.

54. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se ndërhyrja në të drejtat e tij pronësore *"nuk ka qenë e përcjellur me garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit, e si rrjedhojë nuk ka qenë në përputhje me Nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së"*.

55. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallë kërkesën e tij të pranueshme dhe të konstatojë: (i) shkelje të neneve 31, 32, 46 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenet 6, 13 të KEDNJ-së, si dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, dhe (iii) të kthejë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme në rivendosje.

Komentet e BQK-së

56. BQK paraqiti komentet e saja ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, dhe në këtë kontekst përkitazi me aplikueshmërinë e nenit 76 të Ligjit për BQK-në theksoi si në vijim:

> *"Po ashtu, pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë të pabazuara ne lidhje me nenin 76 te Ligjit Nr. 03/L-209 për BQK-ne. Gjykata ka vlerësuar drejt se sipas këtij neni është përcaktuar Imuniteti ndaj caktimit te masës se përkohshme gjyqësore, ndaj BQK-se [...] Në rastin konkret, propozuesi-paditësi me ankesën e ushtruar kërkon që të shtyhet ekzekutimi i Vendimit Nr.77-32/2019, të datës 06.12.2019, te BQK-se për Revokimin e regjistrimit të Institucionit Financiar jobankar "Monego" SH.P.K. deri në marrjen e vendimit gjyqësor. Andaj, duke u bazuar ne dispozitën e lartcekur ne procedure gjyqësore ndaj te paditurës nuk mund te shqiptohet asnjë masë e sigurisë në raport me aktivitetin e cekur si në dispozitën më lartë"*.

57. BQK në vijim pohon se *"Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit nr. ARJ-UZVP.nr.42/2020, ka vlerësuar se gjykata e shkalles së dytë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit, dispozitat e procedurës administrative, ato të Ligjit për konfliktin administrativ.*

Ndërsa, janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljet, ngase vendimi i goditur është i qarte dhe i kuptueshëm".

58. Tutje, BQK arsyeton se "*Banka Qendrore si organ mbikëqyrës dhe e autorizuar nga legjislacioni ne fuqi që të përcjell mbarëvajtjen e sistemit financiar ne Kosove ka vepruar në mënyre të drejtë duke ja revokuar licencën IFJB "Monego" SH.P.K. për shkak të shkeljeve të konstatuara dhe duke marrë për bazë interesin publik dhe demin që mund t'i shkaktoj konsumatorëve financiar me anë të aplikimit të normave të larta të interesit, e me këtë edhe të rrezikoj stabilitetin financiar ne vend. BQK-ja revokoi licencën e këtij institucioni për shkak të shkeljeve në mënyrë sistematike të kërkesave legjislative. Institucioni në fjalë, duke mos zbatuar kërkesat rregullative-ligjore vazhdonte te aplikonte norma te interesit dukshëm më të larta nga ajo që kishte paraparë në planin e biznesit, në bazë të të cilit edhe kishte marrë leje pune".*

59. Në komentet e saj, BQK po ashtu i referohet nenit 77, paragrafit 4 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-në, duke theksuar se *"Për më tepër, duke pas parasysh rëndësinë e ruajtjes se stabilitetit financiar ne vend, vet neni 77 (4) i Ligjit nr. 03/L-209 për BQK, ka paraparë se "ne çfarëdo procedure gjyqësore apo të arbitrazhit kundër Bankës Qendrore, gjykata apo paneli i arbitrazhit nuk do te ndaloje, të pezullojë, të suspendojë apo të shfuqizojë veprimet e marra nga Banka Qendrore".*

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2.Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

Neni 32
[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

[...]

Neni 46
[Mbrojtja e Pronës]

1.E drejta e pronës është e garantuar.
2.Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. 3.Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.
[...]

Neni 54
[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri

demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

Neni 13
(E drejta për zgjidhje efektive)

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Protokolli nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 1
(Mbrojtja e pronës)

1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 7

Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cenon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë.

Neni 8

Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet.

[...]

Neni 10

Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.

LIGJI Nr. 03/L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Neni 22

1. Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe.
2. Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.
3. Bashkë me kërkesën për shtyrje duhet paraqitur prova, që tregon se padia është parashtruar.
4. Për shtyrje të ekzekutimit, organi kompetent nxjerr vendimin brenda tri (3) ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shtyrje.
5. Organi nga paragrafi 2. i këtij neni mund të shtyjë ekzekutimin e aktit të kontestuar edhe për shkaqe të tjera të arsyeshme deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse nuk është në kundërshtim me interesin publik.
6. Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni.
7. Për kërkesën, gjykata vendos brenda tri (3) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.
[...]

Neni 63
Dispozita të tjera të procedurës

Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore.

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 160

160.1 Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet ta ketë: pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin mbi të drejtën e ankimit kundër aktgjykimit.
160.2Pjesa hyrëse e aktgjykimit përmban: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit, emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë, tregimin e shkurtër të objektit të kontestit dhe vlerën e tij, ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor, tregimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancënpër shqyrtimin e tillë si dhe ditën kur është dhënë aktgjykimi.
160.3Dispozitivi i aktgjykimit përmban: vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimine kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale.
160.4 Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.
160.5 Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëvepër bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor.
160.6 Në pjesën arsyetuese të aktgjykimit kontumacional, aktgjykimit në bazë të pohimit, aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, apo të aktgjykimit për shkak të mungesës, jepen vetëm arsyet qëe justifikojnë dhënien e aktgjykimeve të këtilla.

[...]

Neni 306

306.1 Me propozim të propozuesit të sigurimit të paraqitur me propozim për caktimin e masës së sigurimit gjykata mund ta caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po që se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit.
306.2 Vendimin nga paragrafi 1 të këtij neni gjykata ia dërgon kundërshtarit të sigurimit menjëherë. Kundërshtari i sigurimit brenda afatit prej tre (3) ditësh në përgjigjen e tij mund t'i kontestojë shkaqet për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, e pas kësaj gjykata duhet të caktojë seancë në tri ditët e ardhshme. Përgjigja e kundërshtarit të sigurimit duhet të përmbajë pjesën arsyetuese.
306.3 Pas mbajtjes së seancës nga paragrafi 2 e këtij neni gjykata me aktvendim të veçantë e anulon aktvendimin me të cilin e ka caktuar masën e përkohshme ose e zëvendëson me një tjetër aktvendim mbi caktimin e masës së sigurimit në pajtim me nenin 307 të këtij ligji. Kundër aktvendimit të ri për caktimin e masës së sigurimit lejohet ankimi.

LIGJI NR. 03/L-209 PËR BANKËN QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 76
Imuniteti ndaj caktimit të masës së përkohshme gjyqësore

1. Asnjë ndalesë apo ekzekutim nuk mund të shqiptohet ndaj Bankës Qendrore apo pronës së saj, duke përfshirë arin, të drejtat e veçanta të tërheqjes, paratë e gatshme, paratë në llogari, depozitat ose letrat me vlerë, si dhe çdo të ardhur nga to, para shqiptimit të vendimit përfundimtar në çdo veprim ligjor të parashtruar para gjykatave të Kosovës.
2. Banka Qendrore mundet, plotësisht ose pjesërisht, të heqë dorë nga kjo mbrojtje, në mënyrë të qartë dhe me shkrim, me përjashtim të arit dhe të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes që mbahen në llogarinë e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Neni 77
Shqyrtimet gjyqësore

1. Në çfarëdo procedure gjyqësore apo të arbitrazhit kundër Bankës Qendrore, një anëtari të organeve vendimmarrëse apo personelit të Bankës Qendrore apo një agjent i Bankës Qendrore, në lidhje më realizimin e detyrave të tyre ndaj Bankës Qendrore:
[...]
dhe 1.4. gjykata apo paneli i arbitrazhit do të jetë i autorizuar, në rastet e duhura, të caktojë dëmshpërblime monetare për palën e dëmtuar, por nuk do të ndalojë, të pezullojë, të suspendojë apo të shfuqizojë veprimet e marra nga Banka Qendrore.

LIGJI Nr. 04/L-093 PËR BANKAT INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE

Neni 3
Përkufizimet

Institucion financiar jobankar (IFJB)-është personi juridik që nuk është bankë e as institucion mikrofinanciar, që është licencuar nga BQK-ja sipas këtij ligji, për t'u angazhuar në një ose më tepër nga veprimtaritë vijuese: dhënien e kredive, hyrjen në hua dhe kontrata qiradhënie financiare-lizingu, në nënshkrimin, tregtimin, ndërmjetësimin ose shpërndarjen e letrave me vlerë, veprimin si shoqëri investuese ose këshilltar i investimeve apo ofrimin e shërbimeve të tjera financiare siç janë këmbimi valutor; kredit kartat; faktoringun, ose garancitë, ose shërbime të tjera financiare, edukuese-trajnuese, këshillëdhënëse dhe operacionale, si dhe veprimtari te tjera sipas përcaktimit nga BQK-ja;
[...]

Neni 4
Përgjegjësia e BQK-së për dhënien e licencave

1.BQK-ja ka përgjegjësi ekskluzive për dhënien e licencave për të gjitha bankat dhe regjistrimin e të gjitha Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jo-bankare për lëshimin e lejeve të bankave të huaja në lidhje me themelimin e zyrave përfaqësuese.
2.Një regjistër qendror mbahet nga BQK-ja për inspektim nga publiku i cili regjistron për çdo Institucion Financiar, emrin, adresat e drejtorisë qendrore dhe degëve dhe kopjet aktuale të aktit të themelimit apo dokumentacionit të ngjashëm të

themelimit dhe akteve nënligjore. Një listë e të gjitha Institucioneve Financiare, licencat ose regjistrimet e të cilave janë anuluar gjithashtu mbahet në regjistër, por largohet dokumentacioni i tyre i themelimit dhe aktet nënligjore.

[...]

PJESA XXII LIKUIDIMI VULLNETAR, LIKUIDIMI I DETYRUAR DHE ADMINISTRIMI ZYRTAR

[...]

Neni 108
Likuidimi i detyruar

Nëse BQK-ja konstaton se institucioni mikrofinanciar ose institucioni jobankar financiar është insolvent ose me arsye mund të pritet që të bëhet insolvent, BQK-ja mund të revokojë licencën e atij institucioni mikrofinanciar ose institucioni jobankar financiar dhe menjëherë merr në posedim dhe nën kontroll atë institucion mikrofinanciar ose institucion jobankar financiar përmes likuidatorit të caktuar nga BQK-ja. Kjo procedurë do të njihet si likuidim të detyruar dhe për këtë zbatohen dispozitat e këtij ligji, sidomos Pjesa XI.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

60. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

61. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

62. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".*

63. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e pronarit të institucionit financiar jo-bankar ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.,* Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

64. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve, 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

65. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin, ARJ-UZVP.nr.42/2020, e 25 qershorit 2020 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

66. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij, pretendon shkelje të të drejtave themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së; si dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; si dhe nenet 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së.

67. Bazuar në atë si më lart, Gjykata vë në pah se parashtruesi pretendon shkelje të së drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për (i) shkak të interpretimit të gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, respektivisht Gjykatës Supreme dhe (ii) mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

68. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht i referohet pikës (b) të paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës, sipas së cilës, Gjykata mund të konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

69. Prandaj, në kontekst të kësaj të fundit, vlerësimi i këtij kriteri në rrethanat e rastit, është i rëndësishëm sepse procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta, përkatësisht Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ndërlidhet me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së në kuptim të nenit 22, paragrafëve 2 dhe 6 të LKA-së derisa kërkesëpadia për anulimin e këtij Vendimi është në procedurë të shqyrtimit të meritave, dhe rrjedhimisht hyn në fushëveprimin e "procedurave paraprake". Rrjedhimisht, Gjykata do

të vlerësojë nëse neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është i zbatueshëm në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës.

70. Në këtë kontekst specifik, Gjykata vëren se çështja e aplikueshmërisë së nenit 6 të KEDNJ-së në procedura paraprake është interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikes së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën Gjykata, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejta e Njeriut] te Kushtetutës, është e obliguar të interpretoje të drejtat e njeriut dhe liritë themelore te garantuara me Kushtetutë.

71. Gjykata vë po ashtu në pah, se kriteret përkitazi me aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës përkitazi me procedurat paraprake janë përcaktuar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI122/17, me parashtrues, *Česká Exportní Banka A.S.,* Aktgjykim i 30 prillit 2018; KI150/16, parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2018; KI81/19, parashtrues *Skender Podrimqaku,* Aktvendim për papranueshmëri i 9 nëntorit 2019; KI107/19, parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020. Parimet e përgjithshme të vendosura përmes këtyre vendimeve të lartcekura të Gjykatës janë bazuar në rastin e GJENDJ-së, *Micallef kundër Maltës*, Aktgjykim i 15 tetorit 2009.

72. Rrjedhimisht, për të konstatuar nëse kërkesa e parashtruesit të kërkesës është *rationae materiae* në pajtim me Kushtetutën, Gjykata fillimisht do të iu referohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore e GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës për sa i përket aplikueshmërisë së garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në rrethanat e rastit konkret, dhe të cilat ndërlidhen me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së, dhe më pas të njëjtat do t'i aplikojë në rrethanat e rastit konkret.

(i) Parimet e përgjithshme mbi aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 te KEDNJ-së në procedurat paraprake

73. Gjykata fillimisht vë në pah neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ -se, në pjesën civile, zbatohet në procedurat që përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile (shih rastin e GJEDNJ-së: *Ringeisen kundër Austrisë*, Aktgjykim i 22 qershorit 1972, dhe shih rastin e Gjykatës, KI 122/17, parashtrues i kërkesës *Česká Exportní Banka A.S.,* të cituar

më lart, paragrafi 125). Në kontekst të kësaj, Gjykata më tutje thekson se, në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, "procedurat paraprake", si ato që kanë të bëjnë me dhënien e një mase të përkohshme/masë të sigurisë, nuk konsiderohen që përcaktojnë të "drejta dhe detyrime civile" dhe për këtë arsye, në parim, nuk hynë në kuadër të fushëveprimit të mbrojtjes së tillë të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 75 dhe referencat e përdorura në të, shih rastin KI122/17, parashtrues i kërkesës *Česká Exportní Banka A.S.,* paragrafi 126).

74. Megjithatë, përmes Aktgjykimit *Micallef kundër Maltës*, GJEDNJ kishte ndryshuar dhe konsoliduar qëndrimin e saj të mëparshëm përkitazi me mos aplikueshmërinë e garancive procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së në "procedurat paraprake".

75. Përmes këtij Aktgjykimi, GJEDNJ vlerësoi si në vijim:

> *"79. Përjashtimi i masave të përkohshme nga fushëveprimi i nenit 6 deri tani është justifikuar me faktin që ato, në parim, nuk përcaktojnë detyrime dhe të drejta civile. Megjithatë, në kushtet kur shume Shteteve Kontraktuese u duhet te përballen me një akumulim te konsiderueshëm çështjesh për shkak te mbingarkesës së sistemeve te tyre të drejtësisë, gjë që çon në procese të tej zgjatura, vendimi i një gjyqtari për një urdhër ndalues shpesh ndodh që është i barasvlefshëm me një vendim për themelin e çështjes për një kohë të konsiderueshme, nganjëherë edhe përgjithmonë. Rrjedhimisht, shumë herë ndodh që procedurat për masa provizore dhe ato në lidhje me veprimin ligjor kryesor vendosin për të njëjtat "detyrime dhe të drejta civile" dhe japin të njëjtat efekte afat-gjata apo edhe të përhershme."* (shih rastin e GJEDNJ-se: *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim, [DHM], 15 tetor 2009, paragrafi 79)".

76. Bazuar në këtë Aktgjykim të GJEDNJ-së, Gjykata vëren se jo të gjitha masat e sigurisë/masat e përkohshme përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile dhe në mënyrë që neni 6 i KEDNJ-së të konsiderohet i zbatueshëm, GJEDNJ përcaktoi kriteret mbi bazën e të cilave duhet të vlerësohet aplikueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së në "proceduarat paraprake" (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafët 83-86).

77. Sipas kritereve të përcaktuar në rastin *Micallef kundër Maltës*, të cilat kritere edhe kjo Gjykatë i pranoi përmes praktikës gjyqësore, së pari, e drejta në fjalë duhet të jetë "civile" si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe ne procedurat lidhur me masën e sigurisë, brenda kuptimit autonom të këtij nocioni sipas nenit 6 të KEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 84 dhe referencat e përmendura aty, si dhe shih rastet e Gjykatës KI122/17, parashtrues *Česká Exportní Banka A.S.*, të cituar më lart, paragrafi 130; KI81/19, parashtrues *Skender Podrimqaku*, të cituar më lart, paragrafi 47; dhe KI107/19, parashtrues *Gafurr Bytyqi*, të cituar më lart, paragrafi 53). Së dyti, kjo procedurë duhet të përcaktojë në mënyrë efektive të drejtën civile përkatëse (shih rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 85 dhe referencat e përmendura aty, si dhe shih rastet e Gjykatës, KI122/17, parashtrues *Česká Exportní Banka A.S.*, të cituar më lart, paragrafi 131 dhe KI81/19, parashtrues *Skender Podrimqaku*, të cituar më lart, paragrafi 48 dhe KI107/19, parashtrues *Gafurr Bytyqi,* të cituar më lart, paragrafi 53).

78. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të vlerësoj në vijim, nëse këto dy kritere, janë të përmbushura në rrethanat e rastit konkret, duke mundësuar për pasojë, aplikueshmërinë e garancive procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

(ii) Zbatimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e parashtruesit të kërkesës

79. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës i referohen Vendimit të BQK-së përmes të cilit ishte revokuar licenca [nr. 07 – 04/2018] e lëshuar për parashtruesin e kërkesës, dhe përmes të cilit Vendim ishte vendosur që atij t'i revokohet regjistrimi i datës 26 shkurt 2018 si institucion financiar jo-bankar dhe ndaj tij të hapen procedurat e likuidimit bazuar në Ligjin për Bankat.

80. Mundësia e inicimit të procedurave gjyqësore përkitazi me Vendimin e BQK-së, si vendim administrativ është po ashtu e përcaktuar përmes ligjeve dhe rregullave të cituara, përkatësisht dispozitave të LKA-së që rregullojnë procedurën e konfliktit administrativ. Mjetet juridike të përcaktuar me dispozita e LKA-së i mundësojnë parashtruesit të kërkesës kontestimin e Vendimit të BQK-së përkitazi me revokimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë si institucion financiar, duke rezultuar kështu në ekzistimin e një të drejtë civile.

81. Rrjedhimisht, qëllimi i kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit të BQK-së në rastin konkret, është që të paktën për një periudhë të caktuar kohore të sigurojë të njëjtën të drejtë që kontestohet edhe në procedurë administrative përkitazi me meritat e rastit. Në këtë kontekst, paragrafi 6 i nenit 22 të LKA-së përcakton që "*Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni*".

82. Prandaj, bazuar në atë si më lartë, Gjykata gjen se kriteri i parë për aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në procedurat përkatëse paraprake është i përmbushur.

83. Në vijim, Gjykata më tej vëren se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, kërkesa për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit të BQK-së është përcaktues për këtë të drejtë sepse i njëjti është mekanizmi i vetëm i mundshëm për parashtruesin e kërkesës për të pezulluar ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë si institucion financiar dhe procedurës së likuidimit. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se edhe kriteri i dytë për aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në procedurat përkatëse paraprake, është i përmbushur.

84. Prandaj, Gjykata konstaton që në rrethanat e të parashtruesit të kërkesës, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, janë plotësuar kriteret për aplikueshmërinë e garancive procedurale të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

85. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është *rationae materie* në pajtim më Kushtetutën.

86. Për sa i përket përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj e të elaboruara më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.42/2020, të 25 qershorit 2020 të Gjykatës Supreme dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e

nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

87. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës gjithashtu plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Meritat e kërkesës

88. Gjykata, fillimisht rikujton se objekt i shqyrtimit të kërkesës është procedura paraprake, e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore bazuar në nenin 22, paragrafët 2 dhe 6 të LKA-së, në të cilën procedurë është kërkuar shtyrja e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së deri në përfundimin e shqyrtimit të kërkesëpadisë së tij për anulimin e të njëjtit vendim.

89. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës përmes licencës së BQK–së ishte regjistruar si institucion financiar jo-bankar për dhënien e kredive. Si rezultat i Vendimit [Nr.77-32/2019], BQK, më 6 dhjetor 2019 kishte revokuar licencën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës ka aplikuar norma efektive të interesit për kredi dukshëm më të larta se norma efektive e paraqitur në planin e biznesit të paraqitur në BQK. Kundër Vendimit të BQK-së, parashtruesi i kërkesës në procedurë administrative kishte parashtruar kërkesëpadi për anulimin e vendimit dhe të njëjtën kohë në bazë të paragrafëve 2 dhe 6 të nenit 22 të LKA-së kishte paraqitur edhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së. Gjykata Themelore kishte refuzuar kërkesën e tij për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit duke aplikuar kriteret e paragrafëve 2 dhe 6 të nenit 22 të LKA-së, në të cilin rast kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dëshmuar se (i) ekzekutimi i Vendimit deri në vendosjen e meritave të rastit para gjykatave atij do t'i sillte dëm të madh dhe të paripareushëm dhe se (ii) shtyrja e ekzekutimit të Vendimit nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik. Si rezultat i ankesës së tij ndaj Aktvendimit të dytë A.nr. 3029/2019 , të 3 shkurtit 2020 të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit kishte vërtetuar konstatimin e Gjykatës Themelore përkitazi me mospërmbushjen e kritereve të nenit 22 të LKA-së për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së, dhe duke aplikuar edhe nenin 76 të Ligjit për BQK-në kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në fund, pas kërkesës së parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, gjegjësisht Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, të parashtruar në

Gjykatën Supreme, kjo e fundit refuzoi kërkesën e tij si të pabazuar dhe vërtetoi konstatimin e Gjykatës së Apelit.

90. Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e Gjykatës Supreme duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së; si dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; dhe nenet 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së.

I. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

91. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat (i) i "zbatimit të gabuar të ligjit" dhe (ii) mosarsyetimit të vendimit gjyqësor. Në kontekst të pretendimit të tij për "zbatim të gabuar të ligjit", parashtruesi i kërkesës specifikon se Gjykata Supreme në mënyrë të gabuar ka zbatuar nenin 76 të Ligjit për BQK-në, duke arsyetuar se kjo dispozitë nuk është e aplikueshme në rastin konkret.

92. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe zbatimi i saj, është interpretuar gjerësisht nga GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore.

93. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm si rezultat i "aplikimit dhe interpretimit qartazi të gabuar të ligjit" dhe mosarsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Për këtë qëllim, në vijim, Gjykata fillimisht (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme përkitazi me "*aplikimin dhe interpretimit qartazi të gabuar të ligjit"* përmes neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së; dhe me pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret, për të vazhduar më pas edhe me shqyrtimin dhe elaborimin e pretendimit të tij për mosarsyetim të vendimit gjyqësor.

(i) Parimet e përgjithshme përkitazi me aplikimin në mënyrë qartazi të gabuar apo arbitrar të ligjit

94. Gjykata thekson se sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm si rezultat i *"interpretimit dhe zbatimit qartazi të gabuar te ligjit",* ajo do t'i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së.

95. Duke u ndërlidhur me pretendimet në rastin konkret, Gjykata fillimisht thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, ne parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato, (shih rastet e Gjykatës: KI06/17, parashtrues *L.G. dhe pesë të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56; KI75/17, parashtrues *X*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2017; KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues te kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas",* Aktvendim për papranueshmëri i 28 gushtit 2019, paragrafi 60; KI119/19, parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)* Aktvendimin për papranueshmëri i 2 shtatorit 2020, paragrafi 58).

96. Megjithatë, Gjykata, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritet vendore, përkatësisht e në rrethanat konkrete gjykatat, kane detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit; roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në pajtueshmëri me KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe te tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; si dhe shih rastin e Gjykatës KI119/19, parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)* Aktvendimin për papranueshmëri i 2 shtatorit 2020, paragrafi 61). Rrjedhimisht, Gjykata ka theksuar se është kryesisht roli i gjykatave të rregullta që të merren me çështjen e interpretimit të ligjit, përderisa roli i Gjykatës Kushtetuese është që të verifikojë nëse pasojat e një interpretimi të tillë janë në pajtim me Kushtetutën (shih rastin e cituar më lartë KI75/17, parashtrues X, paragrafi 58).

97. Në këtë kuptim, Gjykata në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka theksuar se edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në aspektin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik e që mund të ketë rezultuar në *"konkluzione arbitrare"* apo "*qartazi të paarsyeshme*"

për parashtruesin përkatës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc.*, Aktgjykim, paragrafi 83, *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 184/02, paragrafët 70-74 dhe 84; *Păduraru kundër Rumanisë*, nr. 63252/00, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], kërkesa nr. 33202/96, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bulgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih gjithashtu, rastin e cituar më lart KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57;rastet KI154/17 dhe 05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, paragrafët 60 deri në 65; si dhe rastin KI121/19, parashtrues *Ipko Telecomunications,* Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2020, paragrafi 58, dhe referencat e përdorura aty).

98. Tutje, GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore në kontekst të nenit 6 të KEDNJ-së, gjegjësisht në rastin *Barać dhe të tjerët kundër Malit të Zi konstatoi* shkelje sepse vendimi për të drejtën për kompensim për parashtruesin në këtë rast ishte nxjerrë nga gjykatat bazuar në ligjin i cili nuk ishte në fuqi, dhe i cili ishte shpallur paraprakisht jokushtetues (shih rastin e GJEDNJ-së *Barać dhe të tjerët kundër Malit të Zi*, nr. 47974/06, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2011, paragrafët 30 deri 34). Në anën tjetër, në rastin *Anđelković kundër Serbisë,* GJEDNJ gjeti shkelje sepse duke qenë se legjislacioni për të drejtën e punës kishte përcaktuar qartë rastet në të cilat një punëtor ka të drejtë të kërkojë kompensimin në emër të pushimit vjetor, gjykata e shkallës së dytë, në mënyrë arbitrare kishte ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe i kishte mohuar parashtruesit përkatës këtë të drejtë, përmes një arsyetimi pa asnjë bazë ligjore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Anđelković kundër Serbisë,* nr. 1401/08, Aktgjykim i 9 prillit 2013, paragrafët 24-29, dhe referencat aty).

(ii) Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e parashtruesit të kërkesës

99. Në kuadër të aplikimit të parimeve të vendosura nga GJEDNJ dhe të pranuara nga Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore përkitazi me aplikimin apo interpretimin qartazi të gabuar të ligjit, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme në mënyrë të gabuar kanë aplikuar nenin 76 [Imuniteti ndaj caktimit të masës së përkohshme gjyqësore] të Ligjit për BQK-në, duke rezultuar sipas tij në shkelje të të drejtës së të tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

100. Parashtruesi i kërkesës, në mënyrë specifike pretendon se Gjykata Supreme ka trajtuar kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit siç është përcaktuar me paragrafin 6 të nenit 22 të LKA-së dhe *"Imunitetin ndaj caktimit të masës së përkohshme gjyqësore"* të përcaktuar me nenin 76 të Ligjit për BQK-në si të njëjta apo të zëvendësueshme. Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës nënvizon se "ndalesat" i atribuohen dispozitave të LPK-së, ndërsa "ekzekutimet" i atribuohen dispozitave të LPP-së dhe për pasojë, Gjykata Supreme gjithashtu ka arritur në konstatim të gabuar lidhur me subjektin që i drejtohet.

101. Në këtë aspekt, Gjykata sërish rikujton procedurën e zhvilluar pranë gjykatave të rregullta, e cila procedurë paraprake ishte iniciuar me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit të BQK-së, si vendim administrativ në bazë të nenit 22 të LKA-së.

102. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se baza e shqyrtimit të kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit të BQK-së, pranë Gjykatës Themelore ishte neni 22 i LKA-së, paragrafët 2 dhe 6, e cila dispozitë përcakton kriteret që duhet plotësuar në mënyrë që gjykata të lejojë shtyrjen e ekzekutimit të një vendimi administrativ, siç është rasti me Vendimin e BQK-së.

103. Në vijim dhe në kontekst të kësaj, paragrafët 2 dhe 6 të nenit 22 të LKA-së, përcaktojnë që:

> *[...]*
> *2. Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.*
> *[...]*
>
> *6. Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni.*

104. Në rastin konkret, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit të saj të dytë A.nr. 3029/2019, të 3 shkurtit 2020, në procedurë të rivendosjes duke iu referuar nenit 22, paragrafëve 2 dhe 6 të LKA-së arsyetoi se

parashtruesi i kërkesës nuk e ka bërë të besueshme me provat që gjenden në shkresat e lëndës, se Vendimi i BQK-së: (i) do t'i shkaktojë dëm i cili vështirë do të riparohej dhe se (ii) shtyrja nuk është në interes publik apo që shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm palës kundërshtare.

105. Gjykata më tej rikujton se Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit AA. Nr. 164/2020, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore. Në këtë rast, Gjykata e Apelit specifikoi se Gjykata Themelore konstatimin e saj për refuzimin e kërkesës për shtyrje të Vendimit të BQK-së e ka bazuar në mosplotësimin e kritereve të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 22 të LKA-së. Në vijim, Gjykata e Apelit, në Aktvendimin e saj i referohet edhe nenit 76 të Ligjit për BQK-në duke konstatuar se ankesa e parashtruesit të kërkesës është e pabazuar "*E gjithë kjo për arsye se me Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës është përcaktuar Imuniteti ndaj caktimit të masës së përkohshme gjyqësore, ndaj të padituës ngase me nenin 76 të të njëjtit ligj përcaktohet se* "1. *Asnjë ndalesë apo ekzekutim nuk mund të shqiptohet ndaj Bankës Qendrore apo pronës se saj, duke përfshirë arin, të drejtat e veçanta të tërheqjes, paratë e gatshme, paratë në llogari, depozitat ose letrat me vlerë, dhe çdo të ardhur nga to, para shqiptimit të vendimit përfundimtar në çdo veprim ligjor të parashtruar para gjykatave te Kosovës.* 2. *Banka Qendrore mundet, plotësisht ose pjesërisht, të heqë dore nga çdo mbrojtje, në mënyrë të qarte dhe me shkrim, me përjashtim të arit dhe të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes që mbahen në llogarinë e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar".* Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit përfundoi se "*Andaj duke u bazuar ne dispozitën e lartcekur në procedure gjyqësore ndaj të padituës [Bankës Qendrore] nuk mund të shqiptohet asnjë masë e sigurisë në raport me aktivitetin e cekur si në dispozitën më lartë".*

106. Në kontekst të arsyetimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata rikujton konkludimin e dhënë në këtë Aktvendim, përmes së cilit u konstatua se Gjykata Themelore drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesës, dhe në vijim po ashtu shtoi se" [...] *për të mbështetur këtë qëndrim juridik të shkallës së parë, kjo gjendje faktike bazohet edhe në nenin 76 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe se nuk është cenuar ligji në dem të paditësit me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar".*

107. Në vijim të kësaj, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për rishqyrtim të vendimit gjyqësor të parashtruar në Gjykatën Supreme, ndër të tjera, kishte ngritur edhe çështjen e

zbatimit të nenit 76 të Ligjit për BQK nga Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës kishte specifikuar se Gjykata e Apelit në mënyrë të gabuar ka zbatuar nenin 76 të Ligjit për BQK-në duke theksuar se *"Një interpretim i tillë i kësaj dispozite është tërësisht i gabuar dhe nuk përkon as me frymën e Ligjit për BQK-në si tërësi, e as më përmbajtjen e dispozitës në fjalë në veçanti"*, duke vazhduar se nga leximi i kësaj dispozite *"[...] ndalesat dhe ekzekutimet në fjalë nuk mund të shqiptohen ndaj BQK-së dhe aseteve të saj, kurse në rastin konkret kërkesa për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit është propozuar të drejtohet ndaj procesit të likuidimit të Monego pra që ky proces të ndalohet deri në marrjen e vendimit përfundimtar"*. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës në vijim specifikoi se përmes Aktvendimit të Gjykatës së Apelit është ngatërruar objekti i çështjes, gjegjësisht sipas tij *"Neni 76 i Ligjit për BQK-në vije në shprehje në raste kur ndaj Republikës së Kosovës apo ndaj BQK-së ekzistojnë pretendime nga palë të treta dhe mbi asetet e këtyre të fundit propozohet të vendoset masa e përkohshme"*.

108. Gjykata, në vijim i referohet edhe Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes së cilit kjo e fundit e kishte zbatuar nenin 22, paragrafët 2 dhe 6 të LKA-së dhe i ishte referuar nenit 76 të Ligjit për BQK-në dhe kishte vërtetuar se:

> *"[...] gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejtë duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe duke e vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë me të cilin është refuzuar propozimi i paditësit. Kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit, dispozitat e procedurës administrative, ato të Ligjit për Konfliktin Administrativ."*

109. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata vëren se neni 22 i LKA-së, përkatësisht paragrafët 2 dhe 6 kishin qenë bazë e shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Gjykatës Themelore. Dispozitat e nenit 22 të LKA-së, përkatësisht paragrafët 2 dhe 6 po ashtu ishin zbatuar edhe përmes vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Dhe për pasojë, Gjykata e Apelit dhe në fund edhe Gjykata Supreme respektivisht, kishin vërtetuar edhe konstatimet e Gjykatës Themelore përkitazi me interpretimin dhe zbatimin e nenit 22 të LKA-së në procedurën paraprake në rastin e parashtruesit të kërkesës.

110. Gjykata përsërit se në raste të nxjerrjes së vendimeve administrative sipas nenit 22 të LKA-së palët mund të parashtrojnë kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duke plotësuar kriteret e përcaktuara me paragrafët 2 dhe 6. Bazuar në këto dispozita, barra e

të provuarit në këto raste bie mbi palën e cila kërkon shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Rrjedhimisht, dhe në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës në mënyrë kumulative do duhej të i plotësonte kushtet, në mënyrë që një kërkesë e tillë të aprovohej.

111. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në esencë për aplikimin e nenit 76 të Ligjit për BQK-në, pretendon zbatim të gabuar të këtij neni për shkak të (i) përmbajtjes së këtij neni dhe (ii) subjektit që i është drejtuar. Përkitazi me të parën, parashtruesi i kërkesës thekson se "ndalesat" e "ekzekutimet" vlejnë për masat e përkohshme sipas procedurës kontestimore, dhe ekzekutimet i referohen procedurës përmbarimore, ndërsa përkitazi me të dytën, thekson se neni 76 i Ligjit për BQK-në i referohet BQK-së, e jo parashtruesit të kërkesës.

112. Gjykata po ashtu rikujton komentet e BQK-së, e cila thekson se parashtruesi i kërkesës po kërkon *"që të shtyhet ekzekutimi i Vendimit Nr.77-32/2019, të datës 06.12.2019, të BQK-së për Revokimin e regjistrimit të Institucionit Financiar jobankar "Monego" SH.P.K. deri në marrjen e vendimit gjyqësor"*. Rrjedhimisht, sipas BQK-së, bazuar në nenin 76 të Ligjit për BQK-në, në procedurë gjyqësore, ndaj saj, nuk mund të shqiptohet asnjë masë e sigurisë. Më tej, BQK, në komentet e saj po ashtu i referohet edhe nenit 77, paragrafit 4 të Ligjit për BQK-në, duke theksuar se *"Për më tepër, duke pas parasysh rëndësinë e ruajtjes së stabilitetit financiar në vend, vet neni 77 (4) i Ligjit nr. 03/L-209 për BQK, ka paraparë se "ne çfarëdo procedure gjyqësore apo të arbitrazhit kundër Bankës Qendrore, gjykata apo paneli i arbitrazhit nuk do te ndaloje, të pezullojë, të suspendojë apo të shfuqizojë veprimet e marra nga Banka Qendrore"*.

113. Megjithatë, bazuar në elaborimin si më sipër, Gjykata konsideron se çështja parësore në këtë rast është konstatimi i gjykatave të rregullta nëse parashtruesi i kërkesës ka plotësuar kriteret e përcaktuara sipas paragrafëve 2 dhe 6 të nenit 22 të LKA-së në mënyrë që gjykatat të vendosin për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së. Prandaj, në lidhje me pretendimin e ngritur të parashtruesit të kërkesës përkitazi me nenin 76 të Ligjit për BQK-në, Gjykata konsideron se fakti që Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme në këtë procedurë paraprake përveç zbatimit të nenit 22 të LKA-së i janë referuar edhe nenit 76 të Ligjit për BQK-në, vetëm referimi në nenin 76 të BQK-së nuk ka rezultuar në konkluzione arbitrare.

114. Rrjedhimisht, Gjykata rithekson se vendimi dhe konstatimi i gjykatave të rregullta për refuzimin e shtyrjes së ekzekutimit të Vendimit të BQK-së është bazuar në radhë të parë në vlerësimin e kritereve të nenit 22 të LKA-së, dhe rrjedhimisht referenca edhe në nenin 76 të Ligjit për

BQK-në nga Gjykata e Apelit, nuk e ka penguar këtë gjykatë dhe më pas edhe Gjykatën Supreme të konstatojë se nuk janë plotësuar kriteret e përcaktuara me nenin 22 të LKA-së për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit.

115. Përfundimisht, bazuar në elaborimin si më sipër dhe duke aplikuar parimet e praktikës së Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së përkitazi me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, Gjykata konsideron se interpretimi dhe aplikimi i dispozitave ligjore relevante të përcaktuara me LKA në këtë rast, dhe referimi si mbështetje edhe në nenin 76 të Ligjit për BQK-në, nuk mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin e kërkesës. Kjo për arsye se Gjykata konsideron se konstatimet dhe konkluzionet e gjykatave të rregullta në këtë procedurë paraprake dhe të cilat në mënyrë specifike i referohen kërkesës së parashtruesit për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit të BQK-së mbështeten në radhë të parë në vlerësimin e tyre për plotësim të kritereve të përcaktuar në nenin 22, paragrafëve 2 dhe 6 të LKA-së.

116. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata konsideron se nuk është dëshmuar që ka arbitraritet në interpretimin e dhënë nga gjykatat e rregullta në këtë procedurë paraprake, përfshirë edhe Gjykatën Supreme me rastin e refuzimit të kërkesës së parashtruesit për rishqyrtim të vendimit gjyqësor.

117. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Aktgjykimi ARJ-UZVP.nr. 42/2020, i 25 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme përkitazi me interpretimin dhe aplikimin e ligjit, nuk përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

118. Në vijim, Gjykata do të shtjellojë edhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mosarsyetim të vendimit gjyqësor.

Përkitazi me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor

119. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon mungesë të arsyetimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, duke specifikuar se kjo e fundit nuk është përgjigjur në pretendimet e tij specifike përkitazi me aplikimin e nenit 76 të Ligjit për BQK-në. Prandaj, Gjykata gjatë shqyrtimit dhe elaborimit të këtij pretendimi së pari do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për arsyetim të vendimit gjyqësor, për të vazhduar me aplikimin e këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret.

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore

120. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; Buzescu kundër Rumanisë, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj,* Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic,* Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverbrand*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

121. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring,* paragrafi 44).

122. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-*së Garcia Ruiz kundër*

Spanjës, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Morerira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

123. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI96/16 *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017 shih rastet e Gjykatës KI87/18 parashtrues *"IF Skadeforsikring",* Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; KI138/19 parashtrues *Ibish Raci,* cituar më lart, paragrafi 45; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138).

(ii) Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

124. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të parashtruar në Gjykatën Supreme kishte argumentuar se (i) ishte zbatuar gabimisht e drejta materiale; (ii) ekzekutimi i Vendimit të BQK-së do t'i shkaktonte atij dëm të madh dhe të pariparueshëm; dhe se (iii) shtyrja e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së nuk është në kundërshtim me interesin publik. Në lidhje me pretendimin e tij për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, respektivisht nenit 76 të Ligjit për BQK-në, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Supreme kishte specifikuar se *"Një interpretim i tillë i kësaj dispozite është tërësisht i gabuar dhe nuk përkon as me frymën e Ligjit për BQK-në si tërësi, e as më përmbajtjen e dispozitës në fjalë në veçanti"*

duke vazhduar se nga leximi kësaj dispozite "[...] *ndalesat dhe ekzekutimet në fjalë nuk mund të shqiptohen ndaj BQK-së dhe aseteve të saj, kurse në rastin konkret kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit është propozuar të drejtohet ndaj procesit të likuidimit të Monego pra që ky proces të ndalohet deri në marrjen e vendimit përfundimtar".*

125. Ndërsa në kërkesën e tij para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës së tij për arsyetim të vendimit gjyqësor, e drejtë kjo e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke specifikuar se Gjykata Supreme nuk është përgjigjur në argumentet e parashtruesit të kërkesës, gjegjësisht Gjykata Supreme nuk i është përgjigjur pretendimit të tij për zbatim të së drejtës materiale, përkatësisht zbatimit të nenit 76 të Ligjit për BQK-në. Parashtruesi i kërkesës në kontekst të mos arsyetimit të vendimit gjyqësor, gjithashtu i referohet nenit 63 të LKA-së i cili i përcakton se nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore, dhe në rastin konkret Gjykata Supreme do duhej të aplikonte nenin 160 të LPK-së sa i përket elementeve që duhet të përmbajë Aktgjykimi.

126. Gjykata, duke iu referuar edhe praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, dhe duke u bazuar në rrethanat dhe arsyetimin e gjykatave të rregullta përmes vendimeve të tyre në rastin e parashtruesit të kërkesës, vlerëson se janë kriteret si në vijim që duhet aplikuar dhe vlerësuar nëse Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj ka shkelur të drejtën e tij për vendim të arsyetuar gjyqësor, respektivisht nëse (i) parashtruesi i kërkesës e ka ngritur pretendimin e tij për aplikim të gabuar të nenit 76 të Ligjit për BQK-në para Gjykatës Supreme; dhe (ii) nëse pretendimi i tij ishte vendimtar dhe përcaktues për rezultatin e rastit. Në kontekst të këtyre dy kritereve, Gjykata po ashtu do të vlerësojë nëse aprovimi i pretendimit të tij të ngritur në Gjykatën Supreme do ta ndërronte rezultatin e rastit.

127. Në këtë aspekt, sa i përket kriterit të parë, Gjykata përsërit se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Supreme, gjegjësisht në kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kishte ngritur çështjen e aplikimit të gabuar të nenit 76 të Ligjit për BQK-në, dhe përgjatë pretendimeve të tij ai po ashtu kishte pretenduar çështjen e aplikueshmërisë së kushteve të parapara me nenin 22 paragrafët 2 dhe 6 të LKA-së, përkatësisht rreth çështjeve se (i) ekzekutimi i vendimit të BQK-së do t'i sillte atij dëm që vështirë do riparohej; (ii) shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me

interesin publik dhe se (iii) shtyrja e ekzekutimit nuk do t'i sillte dëm palës kundërshtare.

128. Sa i përket kriterit të dytë, gjegjësisht nëse pretendimi i ngritur nga ana e parashtruesit të kërkesës ka qenë vendimtar dhe përcaktues, Gjykata fillimisht rithekson se procedura paraprake në rastin e parashtruesit të kërkesës është iniciuar përmes nenit 22, paragrafëve 2 dhe 6 të LKA-së, dhe për pasojë, bazë e shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës së tij nga ana e gjykatave të rregullta ishte plotësimi i kritereve të përcaktuara me dispozitat e lartcekura të LKA-së.

129. Duke qenë se procedura ishte iniciuar në bazë të nenit 22 të LKA-së, si bazë kryesore ligjore për përcaktimin e kushteve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve, në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit po ashtu kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte plotësuar kriteret e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 22 të LKA-së.

130. Gjykata rikujton se sa i përket nenit 22 paragrafi 2 dhe 6 të LKA-së, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit AA.Nr.164/2020, të 26 shkurtit 2020, kishte rikujtuar se Gjykata Themelore ka gjetur se propozimi i parashtruesit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit është i pabazuar sepse parashtruesi nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë pretendimin e tij dhe kishte konkluduar që Gjykata Themelore" *në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit",* dhe për më tepër se për të mbështetur qëndrimin juridik të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit kishte theksuar se gjendja faktike bazohet edhe në nenin 76 të Ligjit për BQK-në.

131. Lidhur me këtë, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata e Apelit në Aktvendimin AA.UZH.nr.164/2020, e 26 shkurtit 2020 i ishte referuar edhe nenit 76 të Ligjit për BQK-në, dhe kishte theksuar *"edhe pse i ka munguar arsyetimi dhe dispozita ligjore konkrete materiale e cekur me lartë, kjo nuk ka ndikuar në vendosjen ndryshe të kësaj çështje".*

132. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton nenin 76 (Imuniteti ndaj caktimit të masës së përkohshme gjyqësore) të Ligjit për BQK-në i cili përcakton:

> *"1.Asnjë ndalesë apo ekzekutim nuk mund të shqiptohet ndaj Bankës Qendrore apo pronës së saj, duke përfshirë arin, të drejtat e veçanta të tërheqjes, paratë e gatshme, paratë në*

llogari, depozitat ose letrat me vlerë, si dhe çdo të ardhur nga to, para shqiptimit të vendimit përfundimtar në çdo veprim ligjor të parashtruar para gjykatave të Kosovës.

2.Banka Qendrore mundet, plotësisht ose pjesërisht, të heqë dorë nga kjo mbrojtje, në mënyrë të qartë dhe me shkrim, me përjashtim të arit dhe të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes që mbahen në llogarinë e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar."

133. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj, së pari duke iu referuar paragrafëve 2 dhe 6 të nenit 22 të LKA-së theksoi se *"kjo dispozitë përcakton se shtyrja mund të bëhet me kërkesën e paditësit, organi, akti i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutimin, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrative do ti sillte dem paditësit, i cili vështire do te riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik e as qe shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit te interesuar. Ndërsa me dispozitën e nenit 22.6 të të njëjtit ligj përcaktohet se paditësi mund të kërkoj nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit te aktit administrativ deri ne marrjen e vendimit gjyqësor , sipas kushteve te parapare me nenin 22 par.2 te LKA-së".*

134. Gjykata Supreme përkitazi me aplikimin e nenit 76 të BQK-së kishte theksuar se *"Përveç kësaj, neni 76 i Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës përcakton imunitetin ndaj caktimit të masës së përkohshme gjyqësore, respektivisht asnjë ndalese apo ekzekutim nuk mund të shqiptohet ndaj Bankës Qendrore apo pronës së saj".*

135. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesit të kërkesës, i ngritur në Gjykatën Supreme, dhe që i referohet aplikimit të gabuar të nenit 76 të Ligjit për BQK-në, nuk ishte përcaktues dhe vendimtar për rezultatin e kërkesës së tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor (shih lidhur me ngritjen e argumentit vendimtar për rezultatin e rastit, rastin e GJEDNJ-së, *Ruiz Torija kundër Spanjës,* nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 30).

136. Në fund, në lidhje me atë nëse adresimi i pretendimit të parashtruesit të kërkesës do ta ndërronte rezultatin e rastit, Gjykata vëren se fillimisht Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj kishte shtuar, përkatësisht arsyetimin e saj për refuzimin e kërkesës së tij për shtyrje të ekzekutimit të vendimit e kishte mbështetur edhe në dispozitën e nenit 76 të Ligjit për BQK-në. Përderisa, parashtruesi i kërkesës në

kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm kishte pretenduar aplikim të gabuar të së drejtës materiale, si rezultat i aplikimit të nenit 76 të Ligjit për BQK-në, njëkohësisht kishte pohuar se në rastin e tij ishin plotësuar kriteret sipas paragrafit 2 të nenit 22 të LKA-së.

137. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme konstatoi se *"[...] gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejtë duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe duke e vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë me të cilin është refuzuar propozimi i paditësit. Kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit, dispozitat e procedurës administrative, ato të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Janë të pabazuara thëniet e paditësit lidhur me shkeljet, ngase vendimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm. Arsyetimi i aktvendimit të goditur përmban arsye të mjaftueshme dhe fakte vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme"*.

138. Përfundimisht, dhe duke iu referuar pretendimit të parashtruesit të kërkesës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, Gjykata Supreme konkludoi se: *"Po ashtu kjo Gjykatë vlerëson se është bërë aplikim i drejtë i së drejtës materiale dhe nuk është shkel ligji në dëm të paditësit"*.

139. Gjykata vlerëson se në rastet kur gjykatat e rregullta japin arsyetimin e tyre lidhur me një rast, shkalla në të cilën zbatohet kjo detyrë për të dhënë arsye mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit (shih rastin e GJEDNJ-së, *Ruiz Torija kundër Spanjës,* nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29).

140. Rrjedhimisht, bazuar në atë si më lart, dhe bazuar në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se shqyrtimi apo aprovimi i pretendimit të parashtruesit të kërkesës për aplikim të gabuar të nenit 76 të Ligjit për BQK-në si të bazuar, nuk do ta ndërronte rezultatin në rastin e tij (shih, *mutatis mutandis,* rastin e GJEDNJ-së, *Ankerl kundër Zvicrës,* nr. 17748/91, Aktgjykim i 23 tetorit 1996, paragrafi 38). Kjo për faktin se siç u elaborua më lart, objekt shqyrtimi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës në procedurën paraprake para gjykatave të rregullta ishte shtyrja e ekzekutimit të Vendimit të BQK-së dhe vlerësimi nga këto të fundit nëse ishin plotësuar kriteret e përcaktuara në paragrafin e nenit 22 të LKA-së.

141. Për më tepër, Gjykata po ashtu rikujton se në rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë, si në rastin e parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme, e cila vërteton vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një

gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit e as atë të Gjykatës Themelore përmes të cilave është refuzuar kërkesa për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit të BQK-së por vetëm ka vërtetuar ligjshmërinë e tyre, duke qenë se, sipas Gjykatës Supreme, nuk kishte shkelje esenciale të procedurës administrative dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale në këtë procedurë paraprake (shih, në mënyrë të ngjashme, rastet e Gjykatës KI194/18, parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shkurtit 2020, paragrafi 106; dhe KI122/19, parashtrues *F.M.,* Aktvendim për papranueshmëri, i 9 korrikut 2020, paragrafi 100).

142. Nga sa u tha më lart, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, parashtruesit të kërkesës i janë dhënë mundësitë procedurale për të adresuar pretendimet e tij dhe se në substancë, parashtruesi i kërkesës ka marrë përgjigje ndaj pretendimeve thelbësore të tij të parashtruara në kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësore në Gjykatën Supreme.

143. Prandaj, bazuar në si më sipër, Gjykata konstaton që Aktgjykimi ARJ-UZVP.nr. 42/2020, i 25 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetim gjyqësor, nuk përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

144. Rrjedhimisht dhe në vijim, Gjykata do të shtjellojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

II. Përkitazi me pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës, nenit 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së; dhe nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenet 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së

145. Gjykata së pari rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] e 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së duke specifikuar se mjeti juridik në rastin e tij, është joefektiv si pasojë e mostrajtimit të meritave të rastit edhe pse legjislacioni në fuqi ka paraparë kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit si mjet të qasshëm me ligj.

146. Gjykata së dyti, rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 46

[Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke arsyetuar se pajisja me licencë përbën aset në kuptimin e pasurisë, dhe rrjedhimisht pretendon se në rastin e tij ka pasur ndërhyrje në të drejtat e tij pronësore si pasojë e interpretimit në mënyrë të gabuar të nenit 76 të Ligjit të BQK-së. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të neneve 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së.

147. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendimet e tij të lartcekura përkitazi me nenin 32 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së i ndërlidh me pretendimin për interpretim dhe aplikim të gabuar të ligjit, përkatësisht aplikimit të nenit 76 të Ligjit për BQK-në nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, të cilin pretendim Gjykata pas shqyrtimit dhe elaborimit të tij konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, nuk është nxjerrë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

148. Rrjedhimisht, Gjykata bazuar në konstatimet e saj përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk do të vazhdojë me shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit përkitazi me nenet 32 e 45 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenet 7, 8 dhe 10 të DUDNJ-së dhe si të tilla i shpallë të papranueshme ashtu siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

149. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e pranueshme dhe se:

I. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për (i) shkak të aplikimit të gabuar të ligjit dhe (ii) mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata konstaton se Aktgjykimi i kontestuar ARJ-UZVP.nr. 42/2020, i 25 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme nuk përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Ndërsa, përkitazi me:

II. Pretendimet për shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, dhe nenet 7,

8 dhe 10 të DUDNJ-së, Gjykata konstaton se të njëjtat janë të papranueshme ashtu siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 29 mars 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi, ARJ-UZVP.nr. 42/2020, i 25 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

KI20/21 Parashtrues: Violeta Todorović, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. AC-I-16-0122, të 1 tetorit 2020

KI20/21 - Aktgjykim i datës 13 prill 2021, i publikuar më 30 prill 2021
Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, kërkesë e pranueshme, e drejta në ankesë, qasja në drejtësi*

Parashtruesja e kërkesës nga viti 1990 kishte qenë e punësuar në N.Sh. "Yumco". Pasi kjo e fundit ishte privatizuar, AKP kishte publikuar në media listën përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime në N. Sh. "Yumco" në të cilën listë, parashtruesja e kërkesës nuk ishte e përfshirë. Andaj, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS) lidhur me listën përfundimtare të të punësuarve të N. Sh. 'Yumco" duke kërkuar që emri i saj të përfshihet në listën e të punësuarve me të drejtë në pagesë të pjesës së 20% të të ardhurave. Më 24 maj 2016, Kolegji i Specializuar përmes Aktgjykimit [C-II-13-0444] refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar. Më 15 qershor 2016, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Kolegjit të Specializuar, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit, duke pretenduar se ajo ishte pjesë e N.Sh. "Yumco" edhe pas vitit 1997. Më 4 tetor 2019, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit [AC-I-16-0122], e hodhi poshtë ankesën e parashtrueses së kërkesës si të paafatshme, duke theksuar se Aktgjykimi [C-II-13-0444] i 24 majit 2016, i Kolegjit të Specializuar ishte pranuar nga parashtruesja e kërkesës më 3 mars 2016 dhe sipas mjetit juridik të të njëjtit Aktvendim, është paraparë që mund të paraqitet ankesa në afat prej 21 ditëve. Megjithatë, ankesa është parashtruar më 15 qershor 2016, që tregon që është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar me ligj.

Më 21 tetor 2019, parashtruesja e kërkesës, në Kolegjin e Apelit, kishte paraqitur një kërkesë për përmirësimin e gabimit të qartë teknik, të Aktgjykimit [Ac-I-16-0122] të Kolegjit të Apelit, të 4 tetorit 2019, duke pretenduar se Aktgjykimin [C-II-13-0444] e Kolegjit të Specializuar, të 24 majit 2016 e kishte pranuar më 3 qershor 2016, derisa ankesën kundër këtij Aktgjykimi në Kolegjin e Apelit e ka parashtruar më 15 qershor 2016, brenda afatit prej 21 ditëve. Më 1 tetor 2020, Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [Ac-I-16-0122], e hodhi poshtë kërkesën e parashtrueses së kërkesës si të papranueshme duke shtuar se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit [AC-I-16-0122] i 4 tetorit 2019, është përfundimtar, edhe pse erdhi në përfundim që deklaratat e parashtrueses së kërkesës që Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar është pranuar nga parashtruesja, më 3 qershor 2016, ishin të sakta.

Parashtruesja e kërkesës pretendoi para Gjykatës Kushtetuese se aktvendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.
Gjykata shqyrtoi, fillimisht, pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me të drejtën e "qasjes në gjykatë", si një nga parimet e një gjykimi të drejtë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Pasi trajtoi pretendimet e parashtrueses së kërkesës, Gjykata gjeti se në Aktvendimin [nr. AC-I-16-0122] e 1 tetorit 2020, Kolegji i Apelit përkundër faktit që gjeti se pretendimet e parashtrueses së kërkesës ishin të sakta, dhe rrjedhimisht se ankesa e saj ishte parashtruar sipas afateve të përcaktuara me nenin 10, paragrafi 6 të Ligjit nr. 04/L-033, kjo e fundit refuzoi kërkesën e parashtrueses për përmirësim të gabimit të Kolegjit të Apelit përmes Aktgjykimit të 4 tetorit 2019, duke e konsideruar kërkesën e saj si kërkesë për rishqyrtim të vendimit gjyqësor.

Andaj, vendimet e Kolegjit të Apelit rezultuan në pamundësinë që ankesa e parashtrueses së kërkesës ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të trajtohej në merita përkundër faktit që ankesa e saj ishte paraqitur brenda afatit ligjor. Në këtë mënyrë, Kolegji i Apelit i kufizoi parashtrueses së kërkesës qasjen në gjykatë, si një ndër parimet kryesore të një gjykimi të drejtë. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31.1 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI20/21

Parashtrues

Violeta Todorović

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. AC-I-16-0122, të 1 tetorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Violeta Todorović, nga Graçanica, të cilën e përfaqëson Vlastimir Petrović, avokat nga Graçanica (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin [nr. AC-I-16-0122] e 1 tetorit 2020 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit) lidhur me Aktgjykimin [nr. AC-I-16-0122] e 4 tetorit 2019 të Kolegjit të Apelit.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 janar 2021, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 1 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi, (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

7. Më 2 shkurt 2021, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS) për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 23 shkurt 2021, Gjykata njoftoi AKP-në për regjistrimin e kërkesës dhe njoftoi këtë të fundit se mund të paraqesë komente, nëse ka, lidhur me kërkesën e parashtrueses.

9. Më 23 shkurt 2021, Gjykata kërkoi nga DHPGJS dosjen e plotë të lëndës.

10. Më 1 mars 2021, Gjykata pranoi dosjen e plotë të lëndës nga DHPGJS.

11. Më 13 prill 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

12. Në të njëjtën ditë, Gjykata votoi, njëzëri, që kërkesa është e pranueshme dhe se: *i)* ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; *ii)* shpalli të pavlefshëm, në raport me parashtruesen e kërkesës, Aktvendimin [nr. AC-I-16-0122] e 1 tetorit 2020 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe Aktgjykimin [nr. AC-I-16-0122] e 4 tetorit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës; si dhe *iii)* ktheu Aktvendimin [nr. AC-I-16-0122] e 1 tetorit 2020 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe Aktgjykimin [nr. AC-I-16-0122] e 4 tetorit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

Përmbledhja e fakteve

13. Nga faktet e lëndës rezulton se parashtruesja e kërkesës nga viti 1990, kishte qenë e punësuar në ndërmarrjen shoqërore "Yumco" në Fushë-Kosovë (në tekstin e mëtejmë: N. Sh. "Yumco").

14. Më 16 nëntor 2006, N. Sh. "Yumco" ishte privatizuar.

15. Më 7, 8 e 9 nëntor 2013, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) kishte publikuar në media listën përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime në N. Sh. "Yumco". Parashtruesja e kërkesës nuk ishte e përfshirë në këtë listë.

16. Më 29 nëntor 2013, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur ankesë në DHPGJS lidhur me listën përfundimtare të të punësuarve të N. Sh. "Yumco", duke kërkuar që emri i saj të përfshihet në listën e të punësuarve me të drejtë në pagesë të pjesës së 20% të të ardhurave nga N. Sh. "Yumco".

17. Më 24 maj 2016, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar) përmes Aktgjykimit [C-II-13-0444] e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar, pasi erdhi në përfundim se ajo kishte qenë e punësuar në N. Sh. "Yumco" nga 1 shtatori 1990 deri më 1 nëntor 1997, kur edhe ishte ndërprerë

marrëdhënia e punës në N. Sh. "Yumco" përmes Aktvendimit [M.202] të 1 nëntorit 1997. Andaj, Kolegji i Specializuar arsyetoi se pasi që ankuesja nuk kishte dorëzuar librezën e punës, Kolegji i Specializuar nuk ishte në gjendje që plotësisht të vërtetojë gjendjen faktike, respektivisht, a ka qenë ankuesja e punësuar në N. Sh. "Yumco" pas vitit 1997.

18. Më 15 qershor 2016, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Kolegjit të Specializuar, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit, duke pretenduar shkelje të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të së drejtës materiale. Parashtruesja e kërkesës, pretendonte se ajo ishte pjesë e N. Sh. "Yumco" edhe pas vitit 1997, duke theksuar se më 16 gusht 1998, në bazë të ndryshimit të statusit, ishte regjistruar në regjistrin e *"HK KP Yumco Vranje",* nën numrin [M. 18022], por përkundër ndryshimeve statusore të bëra me bashkimin e ndërmarrjeve, ankuesja ka vazhduar të punojë në të njëjtin vend të punës, në të njëjtën makineri për qepje në ambientet e ndërtesës së fabrikës "Yumco" në Fushë-Kosovë.

19. Më 4 tetor 2019, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit [Ac-I-16-0122], e hodhi poshtë ankesën e parashtrueses së kërkesës si të paafatshme. Lidhur me këtë, Kolegji i Apelit arsyetoi se *"Nga shkresat e lëndës, respektivisht, nga fletëkthesa me të cilën është pranuar aktgjykimi i kontestuar, Kolegji i Apelit vërteton faktin që aktgjykimi [C-II-13-0444] i DHPGJS-së është pranuar nga ana e ankueses më 3 mars 2016 dhe sipas mjetit juridik të të njëjtit aktvendim, është paraparë që mund të paraqitet ankesa në afat prej 21 ditëve. Në rastin konkret, ankuesja ka pasur të drejtë të paraqitjes së ankesës deri më 24 mars 2016, derisa ankesa është parashtruar më 15 qershor 2016, që tregon që është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar me ligj, prandaj, Kolegji i Apelit, ankesën e ankueses e hedh poshtë si të paraqitur pas afatit".*

20. Më 21 tetor 2019, parashtruesja e kërkesës në Kolegjin e Apelit kishte paraqitur një kërkesë për përmirësimin e gabimit të qartë teknik, të Aktgjykimit [Ac-I-16-0122] të Kolegjit të Apelit, të 4 tetorit 2019, duke pretenduar se Aktgjykimin [C-II-13-0444] të Kolegjit të Specializuar, të 24 majit 2016 e kishte pranuar më 3 qershor 2016, derisa ankesën kundër këtij Aktgjykimi në Kolegjin e Apelit e ka parashtruar më 15 qershor 2016, brenda afatit prej 21 ditëve. Andaj, Kolegji i Apelit në Aktgjykimin [Ac-I-16-0122] të 4 tetorit 2019, gabimisht kishte konstatuar se parashtruesja e kishte pranuar Aktgjykimin [C-II-13-0444] të Kolegjit të Specializuar, më 3 mars 2019 pasi në këtë datë, Aktgjykimi i lartcekur i Kolegjit të Specializuar ende nuk ishte nxjerrë.

Andaj, ajo kërkoi nga Kolegji i Apelit që të përmirësoj këtë gabim dhe që të pranoj kërkesën dhe ajo të përfshihet në listë të përfituesve të 20% nga privatizimi N. Sh. "Yumco".

21. Më 1 tetor 2020, Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [Ac-I-16-0122], e hodhi poshtë kërkesën e parashtrueses së kërkesës si të papranueshme. Lidhur me këtë, Kolegji i Apelit arsyetoi në Aktgjykimin [AC-I-16-0122] të 4 tetorit 2019, theksohet se data e pranimit të Aktgjykimit të [C-II-13-0444] Kolegjit të Specializuar nga parashtruesja e kërkesës është 3 marsi 2016. Lidhur me këtë, Kolegji i Apelit, përmes Aktvendimit [Ac-I-16-0122] të 1 tetorit 2020, theksoi se kjo ka qenë e pamundur pasi që Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar [C-II-13-0444] është marrë më 24 maj 2016. Andaj, Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [Ac-I-16-0122] të 1 tetorit 2020, vjen në përfundim që deklaratat e parashtrueses së kërkesës që Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar është pranuar nga parashtruesja më 3 qershor 2016, janë të sakta. Por, megjithatë, Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [Ac-I-16-0122] të 1 tetorit 2020, theksoi se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit [AC-I-16-0122] i 4 tetorit 2019, është përfundimtar. Prandaj, sipas praktikës gjyqësore të DHPGJS-së, vendimet e marra nga ana e Kolegjit të Apelit janë përfundimtare dhe të plotfuqishme dhe nuk mund të rishikohen nga Kolegji i Apelit.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

22. Parashtruesja e kërkesës pretendon se aktvendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.

23. Parashtruesja e kërkesës pretendon se pasi ajo nuk ka qenë e kënaqur me Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar [C-II-13-0444] të 24 majit 2016, *"më 15 qershor 2016, ka ushtruar ankesë në kohë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme – Kolegjit të Apelit që ta fusin në listën përfundimtare të punëtorëve të NSH "Yumko""* që të fitoj të drejtën në pjesën e 20% nga privatizimi. Por, Kolegji i Apelit nxori Aktgjykimin [AC-I-16-0122] të 4 tetorit 2019, *"me të cilin në paragrafin IV të dispozitivit të aktgjykimit, ankesa e Violeta Todorović (A0004), është hedhur poshtë si e paafatshme, derisa në arsyetimin e të së njëjtit aktgjykim në faqe 12, thuhet që ankesa e Violeta Todorovoćit refuzohet si e pabazuar".*

24. Si pasojë e kësaj, parashtruesja thekson se ka bërë *"kërkesë për përmirësim të gabimit kardinal në aktgjykimin përfundimtar C-II-13-0444 të cilin Violeta Todorović e ka pranuar, siç thuhet më 3 mars 2016, që është e pamundur sepse aktgjykimi është marrë më 24 maj 2016, domethënë 2 muaj më vonë, d.m.th. është e palogjikshme që aktgjykimi më parë të dorëzohet e pastaj të merret. Këtë aktgjykim pala e ka pranuar më 3 qershor 2016"*. Megjithatë, ajo thekson se Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit të 1 tetorit 2020, ka refuzuar kërkesën e saj si të papranueshme. Andaj, këto veprime sipas parashtrueses së kërkesës kanë shkelur dispozitat e procedurës kontestimore dhe dispozitave kushtetuese të neneve 24, 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

25. Lidhur me këtë, parashtruesja e kërkesës pretendon se *"Gjykatat e shkallëve më të ulëta, në aktgjykimet e veta nuk kanë qenë të kujdesshme sipas detyrës zyrtare në obligimet dhe detyrat e veta, kështu që ka ardhur deri tek gabimi i qartë kardinal kur nuk ka vlerësuar ankesën edhe pse ka qenë e qartë që nuk [është] e mundur të ushtrohet ankesa në aktgjykim para se që është marrë vet aktgjykimi"*.

26. Andaj, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) të shpallë kërkesën e saj të pranueshme; (ii) të vendos që ka pasur shkelje të *"nenit 24 i cili përshkruan që çdokush është i barabartë para ligjit, nenit 31 i cili përshkruan që çdokush ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe të paanshëm në periudhë të caktuar, nenit 32 i cili përshkruan të drejtën në mjet juridik dhe neni 54 i cili përshkruan të drejtën në mbrojtje gjyqësore"*. dhe (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme [AC-I-16-0122] të 1 tetorit 2020, dhe të kthej rastin në rishqyrtim në DHPGJS.

Pranueshmëria ë kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara*

me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

29. Gjykata gjithashtu më tej i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]".

30. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [nr. AC-I-16-0122] e 1 tetorit 2020 të Kolegjit të Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

31. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit

(1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

Dispozitat relevante ligjore

Ligji nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Nenin 10
Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet

[...]
"6. Pala ka të drejtë të apelojë ndaj aktgjykimit apo aktvendimit të gjyqtarit të vetëm, nën-kolegjit apo Kolegjit të Specializuar – apo ndaj gjykatës që ka kompetencë mbi një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast sipas paragrafit 4. të nenit 4 të këtij Ligji – tek Kolegji i Apelit, duke parashtruar apelin tek Kolegji i Apelit dhe duke dorëzuar atë parashtresë tek palët tjera brenda njëzetenjë (21) ditësh. Apeli parashtrohet edhe para gjykatës, Kolegjit të Specializuar, nën-kolegjit apo gjyqtarit që ka nxjerrë aktvendimin apo aktgjykimin në fjalë, brenda të njëjtës periudhë njëzetenjë (21) ditësh. Ky afat fillon të llogaritet prej mesnatës në atë ditë kur gjyqtari i vetëm, nën-kolegji, Kolegji i Specializuar apo gjykata i ka dorëzuar aktvendimin apo aktgjykimin në fjalë palëve me shkrim. Kolegji i Apelit refuzon apelin nëse pala dështon ta parashtrojë atë brenda periudhës së përcaktuar kohore".

Meritat

32. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës nga viti 1990 kishte qenë e punësuar në N.Sh. "Yumco". Pasi kjo e fundit ishte privatizuar, AKP kishte publikuar në media listën përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime në N. Sh. "Yumco" në të cilën listë, parashtruesja e kërkesës nuk ishte e përfshirë. Andaj, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur ankesë në DHPGJS lidhur me listën përfundimtare të të punësuarve të N. Sh. 'Yumco" duke kërkuar që emri i saj të përfshihet në listën e të punësuarve me të drejtë në pagesë të pjesës së 20% të të ardhurave. Më 24 maj 2016, Kolegji i Specializuar përmes Aktgjykimit

[C-II-13-0444] refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar, pasi erdhi në përfundim se ajo kishte qenë e punësuar në N. Sh. "Yumco" nga 1 shtatori 1990 deri më 1 nëntor 1997, kur edhe i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës. Më 15 qershor 2016, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Kolegjit të Specializuar, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit, duke pretenduar se ajo ishte pjesë e N.Sh. "Yumco" edhe pas vitit 1997. Më 4 tetor 2019, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit [AC-I-16-0122], e hodhi poshtë ankesën e parashtrueses së kërkesës si të paafatshme, duke theksuar se Aktgjykimi [C-II-13-0444] i 24 majit 2016, i Kolegjit të Specializuar ishte pranuar nga parashtruesja e kërkesës më 3 mars 2016 dhe sipas mjetit juridik të të njëjtit Aktvendim, është paraparë që mund të paraqitet ankesa në afat prej 21 ditëve. Megjithatë, ankesa është parashtruar më 15 qershor 2016, që tregon që është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar me ligj.

33. Më 21 tetor 2019, parashtruesja e kërkesës, në Kolegjin e Apelit, kishte paraqitur një kërkesë për përmirësimin e gabimit të qartë teknik, të Aktgjykimit [Ac-I-16-0122] të Kolegjit të Apelit, të 4 tetorit 2019, duke pretenduar se Aktgjykimin [C-II-13-0444] e Kolegjit të Specializuar, të 24 majit 2016 e kishte pranuar më 3 qershor 2016, derisa ankesën kundër këtij Aktgjykimi në Kolegjin e Apelit e ka parashtruar më 15 qershor 2016, brenda afatit prej 21 ditëve. Më 1 tetor 2020, Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [Ac-I-16-0122], e hodhi poshtë kërkesën e parashtrueses së kërkesës si të papranueshme duke shtuar se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit [AC-I-16-0122] i 4 tetorit 2019, është përfundimtar, edhe pse erdhi në përfundim që deklaratat e parashtrueses së kërkesës që Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar është pranuar nga parashtruesja, më 3 qershor 2016, ishin të sakta.

34. Andaj, parashtruesja e kërkesës pretendon para Gjykatës se Kolegji i Apelit ka pasur detyrim ligjor që të trajtojë ankesën e parashtrueses së kërkesës ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar pasi e njëjta është paraqitur brenda afatit ligjor duke pasur parasysh që ajo Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar e kishte pranuar më 3 qershor 2016, ndërsa ankesën e kishte dorëzuar më 15 qershor 2016, pra brenda afatit 21 ditor të përcaktuar me ligj. Megjithatë, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit [Ac-I-16-0122], e hodhi poshtë ankesën e parashtrueses së kërkesës si të paafatshme ndërsa pas kërkesës për përmirësimin e gabimit të qartë teknik, të Aktgjykimit [Ac-I-16-0122] të Kolegjit të Apelit, të 4 tetorit 2019, Kolegjit të Apelit përmes Aktgjykimit [AC-I-16-0122] të 4 tetorit 2019, edhe pse erdhi në përfundim që deklaratat e parashtrueses së kërkesës që Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar është pranuar nga parashtruesja më 3 qershor 2016, ishin të sakta, vendosi se ajo nuk mund të përmirësonte një vendim përfundimtar të

Kolegjit të Apelit. Një qëndrim i tillë, sipas mendimit të parashtrueses së kërkesës, është në kundërshtim me obligimet e gjykatës që rasti i saj të shqyrtohet në merita nga Kolegji i Apelit dhe me këtë kishte ardhur deri te shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

35. Gjykata vëren se bazuar në faktet e lartcekura dhe pretendimet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës, thelbi i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës ndërlidhet me të drejtë për "qasje në gjykatë" si pjesë përbërëse e të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

36. Gjykata i referohet dispozitave përkatëse të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së:

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]:

"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) i KEDNJ-së:

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë".

[...]

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

[...]

(c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë".

37. Gjykata gjithashtu përsërit se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *"[Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

38. Në këtë drejtim, Gjykata së pari vëren se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës vazhdimisht konsideron se drejtësia e procedurës vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih rastin e Gjykatës KI62/17, parashtruese: *Enine Simnica*, Aktgjykim i 29 majit 2018; shih gjithashtu, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 tetorit 1988, paragrafi 68). Prandaj, në procedurën e vlerësimit të bazës së pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata do t'u përmbahet këtyre parimeve.

39. Rrjedhimisht, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me të drejtën e "qasjes në gjykatë", si një nga parimet e një gjykimi të drejtë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Parimet e përgjithshme lidhur me "qasjen në gjykatë"

40. Së pari, Gjykata rikujton se në e rastin KI62/17, cituar më lart, dhe rastin e GJEDNJ-së *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kanë konstatuar se "*e drejta e qasjes në gjykatë përbën një element që është i pandarë në të drejtën e përcaktuar në nenin 6 paragrafi. 1. Neni 6 para. 1 u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedurë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile pranë një gjykate ose tribunali. Në këtë mënyrë, ky nen përfshin "të drejtën për një gjykatë", nga e cila e drejta e qasjes, përkatësisht e drejta për të filluar procedura pranë gjykatave në çështjet civile, përbën vetëm një aspekt të kësaj të drejte".* (shih rastet e Gjykatës KI62/17, cituar më lart, paragrafi 50, dhe rastin e K224/19, parashtrues *Islam Krasniqi*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 34. Shih gjithashtu, rastin e

GJEDNJ *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 21 shkurtit 1975, paragrafët 28-36).

41. Gjykata në këtë kontekst thekson se e "drejta në gjykatë", si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, përcakton që palët në procedurë duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih rastin K224/19, cituar më lart, paragrafi 35; shih gjithashtu, e GjEDNj-së, *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke,* Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 49; dhe *Naït-Liman kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 112).

42. Përveç kësaj, në rastin *Kreuz kundër Polonisë*, GJEDNJ-ja deklaroi e drejta për gjykim të drejtë, *" u siguron të gjithëve të drejtën për të paraqitur kërkesë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile pranë një gjykate ose tribunali. Në këtë mënyrë, kjo dispozitë përmban "të drejtën në gjykatë", të drejtën e qasjes, si një parim që në të vërtetë mundëson përfitim nga garancitë e mëtejshme të parashtruara në paragrafin 1 të nenit 6* (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së: *Kreuz v Polonia*, Aktgjykim i 20 prillit 1998 paragrafi 52).

43. Për më tepër, Gjykata ka theksuar se KEDNJ nuk synon të garantojë të drejtat që janë *"teorike dhe iluzore",* por të drejtat që janë *"praktike dhe efektive"* (shih rastin KI224/19, cituar më lart, paragrafi 39). Prandaj, në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së, e drejta e qasjes në gjykatë nuk nënkupton vetëm të drejtën për të filluar procedurat pranë një gjykate, por, me qëllim që e drejta e qasjes në gjykatë të jetë efektive, individi duhet të ketë gjithashtu një mundësi të qartë dhe reale për të kontestuar vendimin që shkel të drejtat e tij/saj. Me fjalë të tjera, e drejta e qasjes në gjykatë nuk shterohet vetëm në të drejtën për të filluar procedurën në gjykatë, por kuptimi i saj është shumë më i gjerë pasi që përfshin të drejtën për "zgjidhjen" e mosmarrëveshjes nga gjykata kompetente (shih rastin KI62/17, cituar më lart, paragrafi 55).

44. Gjykata më tej thekson se e drejta për qasje në gjykatë nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve, pasi që nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një liri të caktuar vlerësimi në këtë drejtim.

45. Megjithatë, çdo kufizim i të drejtës së qasjes në gjykatë nuk duhet të kufizojë ose zvogëlojë qasjen e një personi në atë mënyrë apo në një masë të tillë që të dëmtohet vetë thelbi i "së drejtës në gjykatë".

Kufizimet e tilla nuk do të jenë të pajtueshme nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet (shih rastin e Gjykatës KI62/17, cituar më lart, paragrafi 58, dhe rastet e GJEDNJ-së: *Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë, Aktgjykim i 16 nëntorit 2000,* para. 15, dhe *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke,* Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi, 61).

46. Prandaj, Gjykata konsideron se kufizimet nuk do të jenë në pajtim me të drejtën për një gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së nëse, *a)* nuk ndjekin një qëllim legjitim; dhe *b)* nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të kërkuar (shih rastin e Gjykatës KI62/17, cituar më lart, paragrafi 59).

Zbatimi i këtyre parimeve dhe garancive në rastin aktual

47. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës në rastin konkret ka pasur qasje në gjykatë, konkretisht në Kolegjit të Specializuar dhe në Kolegjin e Apelit, por vetëm deri në momentin e dorëzimit e ankesës ndaj Aktgjykimit [C-II-13-0444] të Kolegjit të Specializuar, të 24 majit 2016.

48. Kjo pasi, fakti i thjeshtë se parashtruesja e kërkesës kishte mundësi ligjore për t'ia parashtruar këtë kërkesë Kolegjit të Specializuar nuk çon domosdoshmërisht drejt përmbushjes së të drejtës së qasjes në gjykatë që rrjedh nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Prandaj, mbetet të përcaktohet nëse Aktvendimi [nr. AC-I-16-0122] i 1 tetorit 2020 të Kolegjit të Apelit që deklaroi ankesën e parashtrueses si të paafatshme, lidhur me Aktgjykimin [nr. AC-I-16-0122] 4 tetorit 2019 të Kolegjit të Apelit që deklaroi kërkesën për përmirësim të gabimit të qartë të Kolegjit të Apelit si të papranueshme, në mënyrë efektive ia mohoi parashtrueses "të drejtën e qasjes në gjykatë" nga këndvështrimi i parimit të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike, si dhe garancitë e parapara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

49. Në këtë drejtim, Gjykata thekson që "e drejta në ankesë" nuk është definuar ose nënkuptuar në nenin 6 të KEDNJ-së, por nëse ankesa është lejuar me ligj dhe nëse është parashtruar, dhe në këtë rast Kolegji i Apelit, ishte njoftuar për këtë dhe ishte thirrur për të përcaktuar faktet që janë thelbësore për vazhdimin e procedurave në aspektin procedural, atëherë sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, është i

zbatueshëm paragrafi i parë i nenit 6 të KEDNJ-së (shih GJEDNJ *Delcourt kundër Belgjikës*, i 17 janarit 1970, Seria A f. 11-14).

50. Gjykata vëren se arsyeja kryesore për refuzimin e ankesës së parashtrueses nga Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit [Ac-I-16-0122] të 24 majit 2019, ishte sepse kjo e fundit kishte konsideruar se ankesa e parashtrueses së kërkesës ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar ishte e paafatshme.

51. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës pas pranimit të Aktgjykimit [Ac-I-16-0122] të 24 majit 2019 të Kolegjit të Apelit, ka parashtruar kërkesë për përmirësim të gabimit në Kolegjin e Apelit, ku ishin paraqitur fakte dhe dëshmi se ajo e ka dorëzuar ankesën e saj brenda afatit të paraparë me ligj brenda 21 ditësh nga pranimi i vendimit. Megjithatë, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit [AC-I-16-0122] të 1 tetorit 2020, edhe pse erdhi në përfundim që deklaratat e parashtrueses së kërkesës që Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar është pranuar nga parashtruesja më 3 qershor 2016, ishin të sakta, dhe se ankesa ishte paraqitur brenda afatit ligjor, kjo e fundit vendosi se ajo nuk mund të përmirësonte një vendim përfundimtar të Kolegjit të Apelit.

52. Megjithatë, Gjykata vëren se, duke iu përgjigjur kërkesës së parashtrueses për përmirësimin e qartë teknik lidhur me afatin për paraqitjen e ankesës ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, Kolegji i Apelit në Aktvendimin [nr. AC-I-16-0122] e 1 tetorit 2020, deklaroi:

> *"Kolegji i Apelit vërteton që sipas fletëkthesës, data e pranimit të aktgjykimit të kundërshtuar është 03.03.2016, me siguri është fjala për gabim teknik dhe gjykata ka përcjellë këtë gabim duke llogaritur afatin për ankesë prej 21 ditëve prej ditës së përmendur më parë 03.03.2016 që datat e fundit do të ishin ashtu sikurse ka përmendur në aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të datës 4 tetor 2019. Kjo ka qenë e pamundur pasi që aktgjykimi i ankimuar C-II-13-0444 është marrë me datën 24 maj 2016.*
> *Kolegji i Apelit vjen në përfundim që deklaratat e parashtruesit të kërkesës që aktgjykimi i ankimuar është pranuar më 3 qershor 2016, janë të sakta.*
> *Por aktgjykimi i Kolegjit të Apelit AC-I-16-0122 i datës 4 tetor 2019 është përfundimtarë. Prandaj, sipas praktikës gjyqësore të DHPGJS-së, aktgjykimet, aktvendimi i marrë nga ana e Kolegjit të Apelit janë përfundimtare dhe të plotfuqishme. Këtë lloj qasjeje kanë edhe sistemet juridike në përgjithësi që thirren në parimin e sigurisë juridike*

[...]
Edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës, duke vendosur mbi vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të DHPGJS-së, ASC-11-0056-A0001 i datës 7 qershor 2012, në rastin nr. KI103/12, në pikën 23 të aktvendimit për papranueshmërinë e pranuar më 22 mars 2013, duke argumentuar pikën në lidhje me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës së parashtruar para kësaj gjykate, qartë shpreh mendimin e saj juridik. Lidhur me këtë, gjykata vëren që në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 47.2 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
[...]
Prandaj, vendimet gjyqësore të Kolegjit të Apelit si shkallë e dytë e Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme, me asnjë dispozitë procedurale të LPK-në, nuk mund të rishqyrtohen as asnjë Kolegj i Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi që vendimi përfundimtar e marrë në shkallën e dytë nga Dhoma e Posaçme si pjesë e Gjykatës Supreme është përfundimtar dhe në bazë të ligjit, cilido organ ligjor tjetër, të bëjë shqyrtimin e tij të mëtejmë.
Kolegji i Apelit vëren që në rastin konkret, AC-I-16-0122, tashmë ka vendosur Kolegji i Apelit me aktgjykimin e datës 4 tetor 2019, i cili është i plotfuqishëm.
Prandaj, çdo parashtresë i parashtruar kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të Kolegjit të Apelit, siç tashmë është vendosur nga praktika e saj gjyqësore (ASC-09-0106, ASC-11-0063, ASC-11-0107, AC-I—12-0145), duhet të hedhen poshtë si të papranueshme.
Palët, përveç Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 9.15 të LPK-së, nuk kanë në dispozicion siç është përmendur më lart asnjë mjet juridik të kontestojë vendimin përfundimtar të Kolegjit të Apelit. Dispozitat e LPK-së si ligj i veçantë kanë përparësi të zbatimit në LPK, si ligj i përgjithshëm procedural".

53. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se Ligji nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Ligji nr. 04/L-033), në nenin 10, paragrafi 6 (i aplikueshëm në kohën e paraqitjes së ankesës) parasheh:

[...]
"6. Pala ka të drejtë të apelojë ndaj aktgjykimit apo aktvendimit të gjyqtarit të vetëm, nën-kolegjit apo Kolegjit të Specializuar – apo ndaj gjykatës që ka kompetencë mbi një kërkesë, lëndë, procedurë apo rast sipas paragrafit 4. të nenit 4 të këtij Ligji – tek Kolegji i Apelit, duke parashtruar apelin tek Kolegji i Apelit

dhe duke dorëzuar atë parashtresë tek palët tjera brenda njëzetenjë (21) ditësh. Apeli parashtrohet edhe para gjykatës, Kolegjit të Specializuar, nën-kolegjit apo gjyqtarit që ka nxjerrë aktvendimin apo aktgjykimin në fjalë, brenda të njëjtës periudhë njëzetenjë (21) ditësh. Ky afat fillon të llogaritet prej mesnatës në atë ditë kur gjyqtari i vetëm, nën-kolegji, Kolegji i Specializuar apo gjykata i ka dorëzuar aktvendimin apo aktgjykimin në fjalë palëve me shkrim. Kolegji i Apelit refuzon apelin nëse pala dështon ta parashtrojë atë brenda periudhës së përcaktuar kohore".

54. Gjykata konsideron se rregullat procedurale që rregullojnë hapat që duhet të ndërmerren për paraqitjen e një ankese kanë për qëllim që të sigurojnë administrimin e duhur të drejtësisë. Palët në procedurë duhet të presin që rregullat procedurale do të zbatohen. Rregullat e tilla procedurale, apo aplikimi i tyre, nuk duhet të parandalojnë personin ndaj të cilit zbatohen nga përfitimet e mjetit juridik (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së: *Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë, Aktgjykim i 16 nëntorit 2000,* para. 18). Për më tepër, parashtruesit e kërkesës nuk mund të bartin përgjegjësinë dhe pasojat për gabimet që nuk i'u përkasin atyre por institucioneve përkatëse

55. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se në Aktvendimin [nr. AC-I-16-0122] e 1 tetorit 2020, Kolegji i Apelit përkundër faktit që gjeti se pretendimet e parashtrueses së kërkesës ishin të sakta, dhe rrjedhimisht se ankesa e saj ishte parashtruar sipas afateve të përcaktuara me nenin 10, paragrafi 6 të Ligjit nr. 04/L-033, kjo e fundit refuzoi kërkesën e parashtrueses për përmirësim të gabimit të Kolegjit të Apelit përmes Aktgjykimit të 4 tetorit 2019, duke e konsideruar kërkesën e saj si kërkesë për rishqyrtim të vendimit gjyqësor.

56. Andaj, të dy vendimet e Kolegjit të Apelit rezultuan në pamundësinë që ankesa e parashtrueses së kërkesës ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të trajtohej në merita. Në këtë mënyrë, Kolegji i Apelit të dy vendimet e saj, i kufizoi në qasjen e parashtrueses së kërkesës në gjykatë.

57. Gjykata ka theksuar më lart se e drejta e qasjes në gjykatë mund të kufizohet nëse kufizimet *a)* ndjekin një qëllim legjitim; dhe *b)* nëse ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të kërkuar. Megjithatë, Gjykata vëren se, në rastin konkret, qëndrimet e tilla të Kolegjit të Apelit përmes Aktvendimit [nr. AC-I-16-0122] të 1 tetorit 2020 lidhur me

Aktgjykimin [nr. AC-I-16-0122] e 4 tetorit 2019 të Kolegjit të Apelit, në raport me parashtruesen e kërkesës nuk mund të çonin në një qëllim legjitim që do të lejonte kufizimin e të drejtën në qasje në gjykatë. Nga kjo po ashtu rezulton se nuk ka marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura nga Kolegji i Apelit dhe qëllimit të ndjekur, duke pasur parasysh që parashtruesja e kishte paraqitur ankesën e saj ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, brenda afatit të paraparë me ligj. Në këtë aspekt, duke mos trajtuar ankesën e parashtrueses së kërkesës ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, e cila ishte paraqitur brenda afatit ligjor, Kolegji i Apelit i kishte cenuar asaj, thelbin e "së drejtës së qasjes në gjykatë".

58. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se është e drejtë e Kolegjit të Apelit që të marrë vendim në përputhje me juridiksionin e saj, për aprovimin apo refuzimin e ankesës së parashtrueses së kërkesës, por vetëm pasi asaj, në pajtim me dispozitat e aplikueshme, t'i vlerësohet ankesa e saj ndaj Aktgjykimit [C-II-13-0444] të Kolegjit të Specializuar në merita.

59. Andaj, Gjykata konsideron se në rrethana të tilla, parashtruesja e kërkesës është privuar nga e drejta e saj për qasje në gjykatë, si parim i një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

60. Rrjedhimisht Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31.1 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

61. Duke pasur që Gjykata ka gjetur shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, nuk e sheh të nevojshme të shqyrtojë ndaras pretendimet për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 24, 32 dhe 54 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 13 prill 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit

6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm, në raport me parashtruesen e kërkesës, Aktvendimin [nr. AC-I-16-0122] e 1 tetorit 2020 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe Aktgjykimin [nr. AC-I-16-0122] e 4 tetorit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

IV. TË KTHEJË Aktvendimin [nr. AC-I-16-0122] e 1 tetorit 2020 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe Aktgjykimin [nr. AC-I-16-0122] e 4 tetorit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TË URDHËROJË Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më 18 tetor 2021, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;

VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Safet Hoxha	Arta Rama-Hajrizi

KI240/19, Parashtrues i kërkesës: Enver Latifi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AC.nr. 436/18 të 12 dhjetorit 2018

Fjalët kyç: kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë, jashtë afatit kohor, aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës zhvilloi procedurën në gjykatat e rregullta në lidhje me pengimin e posedimit të patundshmërisë, përkatësisht ngastrës kadastrale në pronësi të tij. Gjykata Themelore vërtetoi pronësinë e parashtruesit të kërkesës mbi ngastrën e kontestuar dhe urdhëroi që e njëjta të kthehej në posedim të parashtruesit të kërkesës.

Bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës inicioi procedurën përmbarimore duke kërkuar ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

Gjykatat refuzuan kërkesën për përmbarim të parashtruesit të kërkesës sepse nuk ishte parashtruar në pajtim me ligjin. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion kundër këtij vendimi, i cili ishte refuzuar për shkak të mos-lejueshmërisë.

Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendoi në Gjykatë se me refuzimin e kërkesës për përmbarim janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
Para se të analizonte pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata shqyrtoi nëse parashtruesi i kërkesës i plotësonte të gjitha kërkesat formale për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë. Gjykata vendosi që parashtruesi i kërkesës ishte palë e autorizuar, se kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe se kishte specifikuar aktin e autoritetit publik, kushtetutshmërinë e të cilit e konteston në Gjykatë. Megjithatë, Gjykata arriti në përfundimin se vendimi i fundit në këtë rast në të vërtetë ishte Aktvendimi [Ac. nr. 4637/18] i Gjykatës së Apelit të 12 dhjetorit 2018, dhe se afati fillon të rrjedhë nga data e pranimit të vendimit të sipërpërmendur nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ose nga parashtruesi i kërkesës personalisht dhe se ajo nuk mund të marrë parasysh Aktvendimin [Rev. nr. 59/2019] e Gjykatës Supreme, sepse një kërkesë e tillë nuk lejohet në procedurën e përmbarimit.
Bazuar në këtë, Gjykata arriti në përfundimin se kërkesa nuk ishte parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe duhet të deklarohet e papranueshme për shkak se është e paafatshme

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI240/19

Parashtrues

Enver Latifi

Vlerësim i kushtetushmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit,
AC. nr. 436/18, të 12 dhjetorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Enver Latifi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), nga Berlini-Gjermani, të cilin e përfaqëson avokati Gëzim Brahimaj nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, AC. nr. 463/18, të 12 dhjetorit 2018, i cili i ishte dorëzuar atij më 16 janar 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes të cilit parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të

drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës së Republikës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 30 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama- Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 15 janar 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Me këtë njoftim, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për përfaqësuesin ligjor.

8. Më 23 janar 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin e kërkuar.

9. Më 7 qershor 2020, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit dhe kërkoi një kopje të fletëkthesës nga Gjykata Themelore me datën kur parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, AC. nr. 4367/18, të 12 dhjetorit 2018.

10. Më 28 korrik 2020, Gjykata Themelore njoftoi Gjykatën se rasti PPP. nr. 924/2017 me të gjitha shkresat e lëndës (përfshirë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, AC. nr. 4367/18, të 12 dhjetorit 2018), bazuar në të dhënat në regjistrin e dorëzimit të çështjeve gjyqësore, më 18 prill 2019 i është dorëzuar përmbaruesit privat Isak Islami.

11. Më 11 dhjetor 2020, Gjykata kërkoi një kopje të fletëkthesës nga përmbaruesi privat Isak Islami me datën kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, AC. nr. 436/18, të 12 dhjetorit 2018.

12. Më 17 dhjetor 2020, përmbaruesi privat Isak Islami dorëzoi në Gjykatë vërtetimin ku thuhej se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, AC. nr. 4367/18, i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 16 janar 2019.

13. Më 1 shkurt 2021, Gjykata kërkoi nga përmbaruesi privat Isak Islami që të dorëzojë në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës.

14. Më 18 shkurt 2021, përmbaruesi privat Isak Islami dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës në rastin e kontestuar.

15. Më 26 mars 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës për paafatshmëri.

Përmbledhja e fakteve

Në lidhje me rastin para nesh, u zhvilluan dy grupe të procedurave.

Procedura kontestimore

16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër S. S. për pengim të posedimit dhe uzurpim, duke kërkuar: t'i kthehej në posedim një pjesë e patundshmërisë e cila është regjistruar si ngastër kadastrale nr. 3058/13, fleta poseduese numër 5668 në vendin e quajtur "Rruga e vjetër", me sipërfaqe prej 31 metër katror (në tekstin e mëtejmë: ngastra e kontestuar).

17. Më 18 tetor 2007, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin [C. nr. 1821/2004] aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe vendosi që S. S. t'ia kthejë në posedim parashtruesit të kërkesës ngastrën e kontestuar nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Ky aktgjykim u bë i plotfuqishëm më 28 tetor 2011.

Procedura përmbarimore

18. Më 18 janar 2012, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër debitorit përmbarimor për

përmbarimin e Aktgjykimit [C. nr. 1821/2004] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 18 tetorit 2007.

19. Më 29 maj 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin [E. nr. 70/2012] lejoi ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, me numër C. nr. 1821/2004, të 18 tetorit 2007.

20. Në një datë të pacaktuar, S. S. kundër aktvendimit për lejimin e përmbarimit [numër P. nr. 70/17] parashtroi kundërshtim në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

21. Më 7 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin [E. nr. 70/2012] refuzoi kundërshtimin e debitorit përmbarimor si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 29 majit 2013. Kundër këtij aktvendimi debitori përmbarimor parashtroi kundërshtim me propozimin për shtyrje të procedurës së përmbarimit.

22. Më 29 shtator 2014, Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës së debitorit përmbarimor, refuzoi ankesën e tij si të pabazuar dhe mbështeti Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 7 nëntorit 2013 dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 29 majit 2013.

23. Më 25 gusht 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, në konkluzionin e saj [E. nr. 70/2012] caktoi datën e ekzekutimit të aktvendimit përfundimtar [E. nr. 70/2012] të 29 majit 2013. Në arsyetimin e konkluzionit, Gjykata Themelore thekson, "*Gjykata, në drejtim të kryerjes së përmbarimit në këtë rast përmbarimor, më 22 shtator 2016, duke filluar nga ora 10.00 do ta kthej në posedim te kreditori, si pronar, një pjesë e pasurisë së paluajtshme e cila është regjistruar si PK¬- (... nuk shihet numri...), FP-5668, në vendin e quajtur "Rruga e vjetër", në sipërfaqe prej 31 metra katrorë, e cila në verilindje në gjatësi prej 3.38 metrash, në veri në gjatësi prej 1.37 + 11.86 = 13.23 metra, në lindje në gjatësi 1.79 metra dhe në jugperëndim në gjatësi prej 8.28 + 4,94 metra = 13,21 metra, në adresën rruga "Vëllezërit Fazliu" nr. 38, do t'i dorëzohet në posedim dhe përdorim të lirë kreditorit të ekzekutimit. Eksperti i gjeodezisë, Qemajl Hoda, obligohet të jetë i pranishëm në vendin e ngjarjes, ditën e ekzekutimit, më 22 shtator 2016 në orën 10.00 me qëllim të sqarimit të ekspertizës. Kreditori i ekzekutimit është i detyruar (... nuk shihet një pjesë e tekstit ...) me nenin 284, paragrafi 4 i LPP-së, në ditën dhe orën e mësipërme*".

24. Më 4 tetor 2017, përmbaruesi privat Isak Islami lëshoi urdhrin për lejimin e përmbarimit P. nr. 70/17, në bazë të të cilit lejoi përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, me numër C. nr. 1821/2004, të 3 dhjetorit 2007, i cili është i plotfuqishëm nga 28 tetori 2011, dhe i cili është i ekzekutueshëm nga 10 janari 2012.

25. Në një datë të pacaktuar, S. S. kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit [numër P. nr. 70/17] të përmbaruesit privat Isak Islami parashtroi kundërshtim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke theksuar se urdhri për përmbarim nuk ishte i qartë dhe se nga ai nuk mund të kuptohej në pajtim me Aktgjykimin C. nr. 1821/2004 të 3 dhjetorit 2007, se çfarë kërkon kreditori. E njëjta kërkesë u paraqit për ekzekutim pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, E. nr. 70/12, por procedura e përmbarimit u pezullua plotësisht për shkak të pengesave ligjore, si për ekzekutimin e pronës së paluajtshme ashtu edhe për shpenzimet e procedurës gjyqësore.

26. Më 22 dhjetor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin [PPP. nr. 924/17], miratoi kundërshtimin e S. S. të parashtruar kundër urdhrit për lejimin e ekzekutimit, duke arsyetuar, "*për ekzekutim edhe pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, E. nr. 70/12, por procedura e përmbarimit është pezulluar në tërësi për shkak të pengesave ligjore, si për ekzekutimin e paluajtshmërisë, ashtu edhe për shpenzimet e procedurës gjyqësore. Ka shtuar se nuk mund të kërkohet apo përsëritet përmbarimi për të njëjtat shkaqe kur është pezulluar procedura e përmbarimit dhe ku shkaqet e pezullimit ekzistojnë edhe tani* [...] *Gjykata ka vlerësuar theksimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe ka ardhur në përfundim që Urdhri për lejimin e përmbarimit numër P. nr. 70/17, të datës 04.1 0.20 17, të lejuar nga Zyra Përmbarimore-përmbaruesi privat Isak Islami në Prishtinë është i pa rregullt pasi që propozimin për përmbarim e ka përpiluar vet përmbaruesi privat dhe e ka nënshkruar dhe pastaj të njëjtin propozim për përmbarim i njëjti përmbarues privat e ka lejuar përmbarimin, dhe me këtë rast lejimi i përmbarimit është bërë pa u plotësuar kushti ligjor në kuptim të dispozitës së nenit 3, paragrafi 1 dhe nenin 4, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, nr. 0411-139, që nënkupton se vet kreditori apo i autorizuari i kreditorit duhet ta përpiloj propozimin për përmbarim dhe ta nënshkruaj atë, ndërsa përmbaruesi privat propozimin e kreditorit i cili i plotëson të gjitha kushtet në kuptim të dispozitave nga 99.2 dhe 102 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, duhet të nxjerr urdhër përmbarimor, që në rastin konkret përmbaruesi privat nuk ka vepruar*".

27. Më 9 janar 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [PPP. nr. 924/17] të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 22 dhjetorit 2017, për shkak të, "*shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, si dhe për shkak të shkeljes së të drejtës materiale*".

28. Më 7 qershor 2018, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin [Ac. nr. 1909/18], refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, për shkak se ishte parashtruar jashtë afatit të parashikuar me ligj.

29. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Aktvendimit [Ac. nr. 1909/18] të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimit [PPP. nr. 924/17] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 22 dhjetorit 2017, për shkak të, "*shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*".

30. Më 14 shtator 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin [PPP. nr. 924/17], hodhi poshtë si të palejueshme kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës sepse konstatoi që revizioni nuk ishte i lejuar në procedurën përmbarimore.

31. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [PPP. nr. 924/17] të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 14 shtatorit 2018, për shkak të, "*shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, si dhe për shkak të shkeljes së të drejtës materiale*".

32. Më 12 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin [Ac. nr. 4637/18], refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, duke arsyetuar, "*Duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, përcaktohet se*: "*Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarimore", pasi që në rastin konkret revizioni nuk është i lejuar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka hedhur poshtë si të palejuar revizionin*".

33. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit [Ac. nr. 4637/18] të Gjykatës së Apelit të 12 dhjetorit 2018.

34. Më 11 mars 2019, Gjykata Supreme, me Aktvendimin [Rev. nr. 59/2019], refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar se në procedurën përmbarimore nuk lejohet revizioni.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

35. Në adresimin e tij në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 dhe 34 të Kushtetutës.

36. Parashtruesi e arsyeton kërkesën e tij me faktin se vendimet e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme, "*nuk janë zbatuar dhe respektuar vendimet e lartpërmendura të Gjykatës Komunale në Prishtinë: Aktgjykim i Gjykatës Komunale me C.nr 1821/2004 i plotfuqishëm 28.10.2011 dhe i ekzekutueshëm nga data 10.01.2012, Aktvendimi i Gjykatës Themelore me E. nr 7012012, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit me CA. nr 3710/2013, Konkluzioni E. nr. 70/2012 nga debitori dhe gjithashtu mbi të njëjtën çështje përmbarimore është vendosur dy herë nga e njëjta Gjykatë, njëherë Gjykata Komunale në Prishtinë dhe Gjykata e Apelit në Prishtinë pastaj Gjykata Themelore në Prishtinë për të njëjtën çështje (dy herë) që kemi të bëjmë me res judicata*". I njëjti pretendim u përsërit nga parashtruesi i kërkesës në tri raste në kërkesën e tij.

37. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që vendimi i kontestuar të kthehet në gjendje të mëparshme dhe në rivendosje.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara*

me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

[...]

40. Gjykata më tej shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat tjera të pranueshmërisë, siç parashihet me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata së pari u referohet neneve 47 [Kërkesat individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

41. Për sa i përket përmbushjes së kritereve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, se ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe ka specifikuar aktin e autoritetit publik kushtetutshmërinë e të cilit e konteston në Gjykatë.

42. Megjithatë, Gjykata merr parasysh edhe nenin 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".

43. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]
(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe
[...]".

44. Në vlerësimin nëse janë përmbushur kriteret e nenit 49 të Ligjit në lidhje me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse kriteri për afatin 4 (katër) mujor, i përcaktuar me Ligj është respektuar në raport me "*vendimin përfundimtar*", të nxjerrë si rezultat i "*mjetit juridik efektiv*", siç kërkohet me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Rregullore të punës.

45. Përkatësisht, në vlerësimin nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse vendimi që kontestohet, përkatësisht Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 54/2019 i 11 marsit 2019, është nxjerrë si rezultat i mjetit juridik efektiv, respektivisht, nëse kërkesa për revizion e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, AC. nr. 4637/2018 të 12 dhjetorit 2018 ishte mjet juridik efektiv i cili është i përcaktuar me ligj.

46. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 68 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, i cili përcakton:

"Neni 68
Mjetet e jashtëzakonshme juridike

1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarimore.

2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarueshëm për përmbarimin me dhunë".

47. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. nr. 54/2019, të 11 marsit 2019, hodhi poshtë, si të papranueshme, kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës të përfunduar me Aktvendimin AC. nr. 4637/2018 të Gjykatës së Apelit të 12 dhjetorit 2018, përkatësisht me Aktvendimin P. nr. 924/2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 14 shtatorit 2018, duke arsyetuar:

"se në bazë të nenit 68 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore nuk është lejuar revizioni në procedurë përmbarimore, prandaj vendimi i gjykatës së shkallës së parë mbi hedhjen e revizionit të kreditorit është i drejtë dhe i bazuar në ligj".

48. Gjykata rikujton që në rastin e tij, pas pranimit të Aktvendimit [AC. nr. 4637/2018] të Gjykatës së Apelit të 12 dhjetorit 2018, asgjë nuk e ka penguar parashtruesin e kërkesës për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ai përdori mjete juridike, të tilla si revizioni kundër Aktvendimit [AC. nr. 4637/2018], i cili nuk ishte parashikuar me ligj.

49. Në pajtim me këtë, *"vendimi përfundimtar"*, në kuptim të nenit 49 të Ligjit, është Aktvendimi [AC. nr. 4637/2018] i Gjykatës së Apelit, i 12 dhjetorit 2018, me të cilin është refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit [PPP. nr. 924/17] të Gjykatës Themelore të 14 shtatorit 2017, dhe i cili është përfundimtar dhe kundër të cilit nuk mund të ushtrohet ankesë (shih, *mutatis mutandis, Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, GJEDNJ, vendimi i 14 marsit 2002).

50. Prandaj, nga kjo rrjedh që parashtruesi i kërkesës Aktvendimin [AC. nr. 4637/2018] të Gjykatës së Apelit e ka pranuar më 16 janar 2019, që vërtetohet nga fletëkthesa e dorëzuar në Gjykatë, ndërsa parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë më 26 dhjetor 2019 (shih, ndër të tjera, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese KI201/13, parashtruese: *Sofa Gjonbalaj*, të 17 prillit 2013, si dhe Aktvendimin KI143/19 *Agim Thaqi* i 16 janarit 2020 dhe Aktvendimin KI218/19 *Shani Morina* i 6 marsit 2020).

51. Prandaj, Gjykata konkludon që kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me Aktvendimin [AC. nr. 4637/2018] të Gjykatës së Apelit është dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.

52. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe që të parandalohet që palët dhe personat e tjerë të përfshirë në procedurat gjyqësore të mbahen në gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë kohore (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Sabri Gunes kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 39; dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24).

53. Prandaj, në bazë të arsyeve të cekura më lart, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 26 mars 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi

KI113/20, Parashtrues: IF Skadeforsikring, nga Norvegjia, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 62/2020, të 6 prillit 2020

KI113/20 Aktgjykim i 28 prillit 2021, publikuar më 25 maj 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, kontest civil, e drejta në gjykim të drejtë, kërkesë e pranueshme për shqyrtim, nuk janë gjetur shkelje kushtetuese*

Parashtruesja e kërkesës pretendoi se Aktgjykimi E. Rev. nr. 62/2020 shkel të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të KEDNj-së. Lidhur me pretendimin për shkelje e këtyre dispozitave konkrete parashtruesja e kërkesës theksoi se Aktgjykimi i kontestuar i 6 prillit 2020, sërish karakterizohet nga mungesa e arsyetimit adekuat, sepse Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetime të mjaftueshme dhe adekuate përkitazi me ndryshimet e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ae. nr. 191/2017, të 31 tetorit 2017, në lidhje me kamatëvonesën, duke shkelur kësisoj parimin e ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës pretendoi se moszbatimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese lidhur me mungesën e arsyetimit përbën shkelje serioze të nenit 31 të Kushtetutës. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesja e kërkesës iu referohet rasteve KI55/09, KI135/14, KI97/16 dhe KI138/15 ku Gjykata kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Në këtë rast, Gjykata konsideroi se të gjitha vërejtjet e dhëna nga Gjykata në Aktgjykimin e saj të 27 shkurtit 2019 (rasti KI87/18), për sa i përket arsyetimit të pikës 2 (dy) të Aktgjykimit të kontestuar, se mbi cilën bazë ligjore a ligj e kishte mbështetur Gjykata Supreme ndryshimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit përkitazi me lartësinë e normës së interesit (kamatëvonesës), tashmë janë konsumuar sepse Aktgjykimi i kontestuar, përmban arsyetim logjik dhe sqaron me saktësi se përse në rastin e parashtrueses së kërkesës nuk mund të aplikohet norma në lartësinë prej 12%, duke theksuar se kjo normë e interesit aplikohet vetëm kur kërkesat për dëmshpërblim bëhen nga personat e dëmtuar, ndaj të cilëve nuk është shlyer detyrimi brenda afateve të përcaktuara sipas nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Përveç kësaj, Gjykata thekson se është konsumuar dhe pretendimi për moskonsistencë në vendimmarrje, përmes nxjerrjes së mendimit juridik nga ana e Gjykatës Supreme. Kësisoj janë eliminuar edhe shkaqet të cilat kanë shkaktuar pasiguri juridike për shkak të zbatimit jo uniform të praktikës gjyqësore për çështje faktike dhe juridike të njëjta.

Si përmbledhje, lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor, Gjykata konkludoi se Gjykata Supreme: (i) ka dhënë bazën juridike dhe ka shpjeguar se përse në rastin e parashtrueses së kërkesës nuk zbatohet norma e interesit prej 12%; (ii) Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmban lidhje logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe përfundimeve të nxjerra; (iii) si rrjedhojë logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe përfundimeve ka rezultuar se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, E. Rev. 62/2020, e plotëson kushtin e një vendimi të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor. Për më tepër, i njëjti është edhe në linjë me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme, të 2 dhjetorit 2020. Andaj, Gjykata konkludoi se parashtruesja e kërkesës, në baza kushtetuese, nuk e mbështet mjaftueshëm pretendimin, se në rastin e saj ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, për pamjaftueshmëri të arsyetimit gjyqësor.

Andaj, Gjykata konkludon se, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI113/20

Parashtrues

IF Skadeforsikring, nga Norvegjia

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
E. Rev. nr. 62/2020, të 6 prillit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtrues i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Kompania e Sigurimeve IF Skadeforsikring, nga Norvegjia (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqësojnë avokatët Visar Morina dhe Besnik Nikqi, nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 62/2020, të 6 prillit 2020, të cilin e ka pranuar më 18 maj 2020.

3. Parashtruesja e kërkesës parashtron për herë të dytë kërkesë në Gjykatë. Më parë kishte parashtruar kërkesën KI87/18, për të cilën Gjykata nxori Aktgjykim më 27 shkurt 2019, dhe kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNj).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 korrik 2020, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 21 korrik 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

8. Më 3 gusht 2018, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Një kopje e kërkesës në pajtim me Ligjin iu dërgua Gjykatës Supreme.

9. Më 22 tetor 2020, Gjykata kërkoi qëndrim juridik nga Gjykata Supreme lidhur me kërkesat KI74/19, KI111/19, KI09/20 dhe KI113/20, në të cilat objekti i vlerësimit të kushtetutshmërisë janë aktgjykimet e Gjykatës Supreme, me të cilat është vendosur për të drejtën e subrogimit të borxhit dhe normën e interesit (kamatëvonesën), për kontestet civile të iniciuara nga kompanitë e sigurimeve.

10. Më 24 nëntor 2020, Gjykata përsëriti kërkesën e saj drejtuar Gjykatës Supreme më 22 tetor 2020.

11. Më 2 dhjetor 2020, Gjykata Supreme dorëzoi një mendim juridik, përmes të cilit shpreh qëndrimin e saj për unifikimin e praktikës gjyqësore përkitazi me aplikimin e normave të interesit për të gjitha llojet e kontesteve civile.

12. Më 28 prill 2021, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe vlerësim në merita.

13. Të njëjtën ditë, Gjykata votoi, njëzëri, që kërkesa është e pranueshme; dhe me shumicë votash, se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përmbledhja e fakteve

Faktet e rastit lidhur me kërkesën e parë KI87/18

14. Më 26 korrik 2009, kishte ndodhur një aksident trafiku, në të cilin u përfshinë dy automjete të pasagjerëve, një i markës "Mercedes", me targa të Republikës së Kosovës, i siguruar në kompaninë e sigurimeve "SIGMA", i cili i kishte shkaktuar dëme materiale automjetit tjetër të pasagjerëve të markës "Audi", me targa të Norvegjisë, i cili posedonte sigurim "kasko" të kompanisë IF Skadeforsikring nga Norvegjia.

15. Më 19 tetor 2010, parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë në kompaninë e sigurimeve "SIGMA", me të cilën kërkoi pagesën e dëmit mbi bazën e regresit, i cili ishte nga aksidenti i trafikut, por kompania "SIGMA" nuk ishte përgjigjur në këtë kërkesë.

16. Më 9 korrik 2012, parashtruesja paraqiti padi në Gjykatën Themelore kundër kompanisë "SIGMA", në të cilën kërkoi që në emër të dëmit të shkaktuar t'i paguhet shuma prej 23,609.24 €, me kamatëvonesën prej 12 %, dhe atë prej 19 tetorit 2010.

17. Më 23 nëntor 2015, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin I. C. nr. 281/2012, me të cilin e miratoi kërkesëpadinë e parashtrueses në tërësi. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet: *"Me nenin 939, paragrafi 1 të LMD-së është përcaktuar se me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën*

e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi çfarëdo baze është përgjegjës për dëmin, ndërsa me nenin 3 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia është përcaktuar se siguruesi është përgjegjës për kompensimin e dëmeve të shkaktuara personave të tretë, nga përdorimi i automjetit të siguruar mbi bazën e autopërgjegjësisë. Nga dispozitat ligjore të lartcekura rrjedh se paditësi si sigurues i automjetit të aksidentuar mbi bazën e sigurimit auto kasko, ka qenë i detyruar ta kompensoj dëmin e shkaktuar mbi automjetin e siguruar, gjë të cilën edhe e ka bërë, dhe njëkohësisht gëzon të drejtën që të regresoj shumën e paguar nga i padituri si sigurues i automjetit "Audi A6", mbi bazën e sigurimit nga autopërgjegjësia për dëmet e shkaktuara personave të tretë. Gjykata e miratoj kërkesëpadinë edhe përkitazi me kamatën e kërkuar të vonesës, në shkallën prej 12 % në vit, duke vendosur kështu në përputhje me nenin 26.6 të Ligjit për sigurimet e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia".

18. Kompania e sigurimeve "SIGMA" paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit për kamatën, vendimit për shpenzimet e procedurës dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

19. Më 31 tetor 2017, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin Ae. nr. 191/2015, me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e kompanisë "SIGMA". Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet: *"Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 939 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (në tekstin e mëtejmë: LSD), për shkak se nga shkresat e lëndës dhe nga provat e administruara rezulton se përgjegjës për dëmin e shkaktuar ka qenë i siguruari i të padituës, paditësja ia ka paguar të siguruarit të saj kompensimin e dëmit të pësuar dhe me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar te paditësja. Për gjykatën e shkallës së dytë nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore të së padituës sa i përket lartësisë së kamatës dhe kohëzgjatjes së llogaritjes së saj ngase kamata llogaritet nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatë e që në rastin konkret drejtë është vlerësuar llogaritja e kamatës duke u bazuar nga neni 26 par. 6 i LSD-së. Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të së padituës, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar ligjin material, ndërsa pretendimet e të padituës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës".*

20. SIGMA paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, lartësisë së shumës monetare, si dhe për shkak të lartësisë së kamatës dhe periudhës kohore të llogaritjes së saj.

21. Parashtruesja iu përgjigj gjithashtu kërkesës për revizion, duke pretenduar "*se revizioni nuk lejohet sipas nenit 214. 2 të Ligjit 04/L-118 (për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-006 për procedurën kontestimore), me arsyetimin se revizioni tërësisht i referohet vetëm vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, respektivisht se pretendimet e të paditurës nga revizioni nuk trajtojnë ndonjë shkelje të dispozitave të LPK-së apo aplikimit të gabuar të së drejtës materiale*".

22. Më 24 janar 2018, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin E. Rev. nr. 27/2017, me të cilin: *"I. Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, nr. 191/2015 datë 31.10.2017, në pjesën e cila ka të bëjë me detyrimin e të paditurës që në emër të regresit nga baza e sigurimit kasko, paditësit t'ia paguaj shumën prej 23.609,24 €, në afat prej 7 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit. II. Pranohet revizioni i të paditurës, ndryshohet aktgjykimi i goditur përkitazi me kamatën, ashtu që obligohet e paditura që paditësit shumën prej 23.609,24 €, t'ia paguajë me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, nga paraqitja e padisë më 19.11.2010, e deri në pagesën definitive"*.

23. Gjykata Supreme në paragrafin e parë të dispozitivit, i cili ka të bëjë me refuzimin e kërkesës për revizion e të paditurës, theksoi: *"Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Në aktgjykimet e tyre ato kanë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë e revizionit"*.

24. Gjykata Supreme në paragrafin e dytë të dispozitivit, i cili ka të bëjë me miratimin e revizionit të të paditurës dhe ndryshimin e Aktgjykimit, theksoi: *"Lidhur me caktimin e kamatës aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, andaj si pasojë patën ndryshimin e tyre, ashtu që paditësit shumën prej 23.609,24 €, e paditura duhet t'ia paguajë me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të*

cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, nga data 19.11.2010, e deri në pagesën definitive, kjo ngase Ligji për Sigurimet e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia ka hyrë në fuqi në vitin 2011 ndërsa rasti ka ndodhur në vitin 2009 dhe si i tillë nuk gjen zbatim për rastin konkret".

25. Më 27 shkurt 2019, Gjykata Kushtetuese, duke vendosur për kërkesën KI87/18 erdhi në përfundim dhe konstatoi se Gjykata Supreme si gjykatë e instancës së fundit, duke marrë një qëndrim të ndryshëm në Aktgjykimin e kontestuar në një rast i cili është plotësisht identik ose i ngjashëm me rastet e tjera, pa dhënë një arsyetim të qartë dhe të mjaftueshëm për këtë, ka shkelur të drejtën e parashtrueses së kërkesës për një vendim të arsyetuar gjyqësor. Kjo çoi edhe në shkelje të parimit të sigurisë juridike, si një nga komponentët themelor të sundimit të ligjit, i cili gjithashtu është një element i pandashëm i së drejtës për një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6. paragrafi 1 të KEDNj-së. Në pikën IV të pjesës operative, Gjykata vendosi: *"TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate".*

Faktet e rastit në lidhje me kërkesën e tanishme KI113/20

26. Më 6 prill 2020, Gjykata Supreme, duke vendosur sipas urdhrit të Gjykatës Kushtetuese, rishqyrtoi kërkesën për revizion të parashtrueses së kërkesës dhe nxori Aktgjykimin E. Rev. nr. 62/2020, përmes të cilit:

i. refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtrueses së kërkesës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ae. nr. 191/2015, të 31 tetorit 2017, në pjesën që ka të bëjë me detyrimin e të paditurës (SIGMA) që në emër të regresit nga baza e sigurimit auto-kasko t'ia paguajë parashtrueses së kërkesës shumën prej 23.609,24 Euro, në afat prej 7 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit;

ii. aprovoi pjesërisht revizionin e parashtrueses së kërkesës, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ae. nr. 191/2015, të 31 tetorit 2017 në pjesën (II) të dispozitivit si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, EK. nr. 281/2012, të 23 nëntorit 2015, në pjesën (I) të dispozitivit, duke e detyruar kompaninë e sigurimeve "SIGMA", që parashtrueses së kërkesës t'ia rimbursojë shumën prej 23,609.24 Euro, me kamatë në lartësi të deponimeve kursimore të afatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi një vit, duke filluar nga 19 tetori 2020, deri në përmbushjen përfundimtare të pagesës.

27. Më 14 korrik 2020, e pakënaqur me Aktgjykimin e kontestuar parashtruesja e kërkesës parashtroi në Gjykatë kërkesën KI113/20, përmes së cilës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së të njëjtit, duke pretenduar shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë, që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së.

28. Më 22 tetor dhe 24 nëntor 2020, Gjykata, duke parë numrin në rritje të kërkesave që vinin për çështjen e subrogimit të borxhit dhe aplikimit të lartësisë së normës së interesit (kamatëvonesës) nga Gjykata Supreme kërkoi mendim juridik, para se të vendoste për kërkesat KI74/19, KI111/19, KI09/20 dhe KI113/20.

29. Më 2 dhjetor 2020, Gjykata Supreme dorëzoi në Gjykatë një mendim juridik, përmes së cilit shpreh qëndrimin e saj për unifikimin e praktikës gjyqësore, për të gjitha kërkesat ku për objekt shqyrtimi kanë aplikimin e normës së interesit, bazuar në ligjin e aplikueshëm në kohën e lindjes së marrëdhënies juridiko-civile.

30. Në vijim, pjesa relevante që tregon qëllimin e nxjerrjes së mendimit juridik nga ana e Gjykatës Supreme:

Arsyetimi i Mendimit Juridik

"Gjykata Supreme e Kosovës, në praktiken e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave me të ulëta ka konstatuar praktikë jo unike lidhur me çështjen e kërkesave për kamatën. Praktika jo unike e gjykatave të instancave me të ulëta kryesisht ka të bëjë me ligjin e aplikueshëm, normën e interesit dhe kohën e rrjedhës së kamatës.

Gjykata Supreme nga praktika e saj, por edhe nga kërkesat e vazhdueshme që ka pranuar nga gjykatat dhe gjyqtarët, e vlerëson me interes për standardizimin e praktikës gjyqësore, adresimin e çështjes së kamatave përmes një mendimi juridik.

Juridiksioni i Gjykatës Supreme të Kosovës, që të nxjerrë mendim juridik në rastet kur vërehet praktika jo unike e zbatimit të ligjit nga gjykatat e rregullta, apo sfidat në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore, përcaktohet me Ligjin për Gjykatat, neni 27 i Ligjit, me dispozitat e të cilit përcaktohet Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme, ndërsa nevoja e adresimit të kësaj çështjeje përmes mendimit juridik është rrjedhë si propozim dhe konkludim i Degës Civile të Gjykatës Supreme, pas shqyrtimit, analizës dhe vlerësimit të një numri të konsiderueshëm të vendimeve gjyqësore për çështjen e kamatës, e po ashtu edhe nga kërkesat, pyetjet apo sugjerimet e gjykatave të rregullta apo gjyqtarëve.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nxjerrja e këtij mendimi juridik do t'i kontribuojë në radhë të parë unifikimit të praktikës

gjyqësore, vendosjes së standardit të ligjshmërisë në vendimmarrjen gjyqësore për çështjen e kamatave, efikasitetit, performancës së gjyqtarëve dhe besimit të publikut në gjykata. Kjo për shkak se përmes standardizimit të praktikës gjyqësore ndikohet në ligjshmërinë e vendimmarrjes, efikasitetin dhe besueshmërinë e publikut në gjykata.

*Objekt i këtij mendimi juridik janë pothuajse të gjitha situatat e kërkesave për kamatën për sa i përket ligjit të aplikueshëm, normës së interesit dhe kohën e rrjedhës së kamatës me disa përjashtime që kanë të bëjnë me çështje që rregullohen me ligje të veçanta. *
Arsyetimi i këtij mendimi juridik ndjek kronologjinë e çështjeve të trajtuara sipas ndarjes në pika."

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

31. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktgjykimin E. Rev. nr. 62/2020 është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të KEDNj-së. Pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, parashtruesja e kërkesës e ndërlidhë me arsyet se Gjykata Supreme nuk e ka arsyetuar vendimin e saj, dhe se e njëjta nuk ka vendosur sipas gjetjeve të Gjykatës Kushtetuese dhe sipas praktikës së GjEDNj-së.

Përkitazi me pamjaftueshmërinë e arsyetimit të vendimit gjyqësor

32. Në lidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi kontestuar i 6 prillit 2020, sërish karakterizohet nga mungesa e arsyetimit adekuat, sepse Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetime të mjaftueshme dhe adekuate përkitazi me ndryshimet e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ae. nr. 191/2017, të 31 tetorit 2017, në lidhje me kamatëvonesën, duke shkelur kësisoj parimin e ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje. Këtë pretendim parashtruesja e kërkesës e mbështet në faktin se Gjykata Supreme në arsyetimin e Aktgjykimit të kontestuar vetëm se ka listuar vërejtjet nga Aktgjykimi KI87/18 i Gjykatës Kushtetuese dhe nuk i është përmbajtur rekomandimeve të saj. Në thelb dhe për pasojë parashtruesja e kërkesës pretendon se arsyetimi i Aktgjykimit të kontestuar, E. Rev. nr. 62/2020 rezulton të ketë të njëjtat mangësi, sepse përmban arsyetim të pamjaftueshëm, respektivisht mungesë të justifikimit dhe shpjegimeve objektive që arsyetojnë këtë shmangie të konsistencës përkitazi me qëndrimet paraprake të kësaj gjykate, lidhur me institutin e kamatëvonesës nga sigurimet e detyrueshme.

33. Në përgjithësi, parashtruesja e kërkesës thekson se elaborimi i çështjes në tërësi, në Aktgjykimin E. Rev. nr. 62/2020, të 6 prillit 2020 nuk dallon nga Aktgjykimi paraprak, respektivisht ky arsyetim është përfshirë në katër paragrafët e fundit të Aktgjykimit. Kësisoj, sipas parashtrueses së kërkesës rezulton se Gjykata Supreme me këtë arsyetim të shkurtër, ndryshimin e qëndrimit dhe jokonsistencën lidhur me institutin e kamatëvonesës nga sigurimet e detyrueshme e mbështet në të njëjtin argument, se kinse nuk mund të ketë veprim retroaktiv Ligji nr. 04/L-018 për këtë rast të siguruar. Tutje, parashtruesja e kërkesës shton se, në pjesën e arsyetimit janë evidente qëndrimet kundërthënëse të Gjykatës Supreme kur i referohet të njëjtit Ligj nr. 04/L-018, respektivisht dispozitës së nenit 26 të tij me konkluzionin: "*se në konteste për subrogim të dëmit ligjërisht nuk aplikohet kamatëvonesa e përcaktuar me nenin 26.6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia". Sipas parashtrueses së kërkesës ky konkluzion fare nuk korrespondon me përmbajtjen e dispozitës se përmendur të ligjit, sepse nuk bën asnjë dallim përkitazi me pretendimin e kërkesave në sigurime qofshin ato kërkesa të drejtpërdrejta apo të subrogimit, e më së paku që të dëmtuarit mbi bazën e subrogimit të mos e kenë statusin e "personit të dëmtuar"*. Siç shihet nga dispozita e ligjit (neni 26.6) nuk kemi një përkufizim të tillë ku shprehimisht thuhet se për kërkesat e subrogimit nuk aplikohet kamatëvonesa. Ky interpretim sipas parashtrueses së kërkesës nuk mund të kualifikohet ndryshe veçse një qëndrim "*de lege ferenda*" i kësaj gjykate.

34. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës pretendon se moszbatimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese lidhur me mungesën e arsyetimit përbën shkelje serioze të nenit 31 të Kushtetutës. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesja e kërkesës iu referohet rasteve KI55/09, KI135/14, KI97/16 dhe KI138/15 ku Gjykata kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

35. Kësisoj, parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur dhe jurisprudencën e GjEDNj-së, e cila ka mbajtur qëndrimin e saj se nocioni i gjykimit të drejtë kërkon, mes tjerash nga gjykatat nacionale, të të gjitha instancave që t'i adresojnë të gjitha çështjet esenciale të rastit kur shqiptojnë vendimet e tyre gjyqësore. Tutje, parashtruesja e kërkesës mëton se vendimmarrja e Gjykatës Supreme është në kundërshtim edhe me kërkesat e nenit 53 të Kushtetutës, sipas së cilit gjykatat janë të detyruara të interpretojnë të drejtat e njeriut në harmoni me praktikën e GjEDNj-së.

36. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, duke injoruar në tërësi çështjet rreth bazës juridike të institutit të kamatëvonesës duke përcaktuar ndryshe lartësinë e normës së kamatëvonesës me Aktgjykimin e kontestuar, E. Rev. nr. 62/2020 nuk i ka plotësuar kërkesat që burojnë nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së lidhur me mjaftueshmërinë e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

37. Tutje pretendohet se defektet e sipërpërmendura juridike të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, cenojnë seriozisht të drejtën e parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së. Andaj, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata, që pas vlerësimit të pretendimeve të saj, të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 62/2020, të 6 prillit 2020, për shkak të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së, dhe të njëjtin ta kthejë në rishqyrtim.

38. Në mbështetje të pretendimeve të saj, parashtruesja e kërkesës sërish dorëzoi në Gjykatë disa aktgjykime të Gjykatës Supreme për të dëshmuar se Gjykata Supreme nuk e kishte ndjekur praktikën e saj gjyqësore, siç janë: E. Rev. nr. 23/2017, 23 dhjetor 2017, E. rev. nr. 48/2014, 13 maj 2014, E. Rev. nr. 62/2014, 21 janar 2015, E. Rev. nr. 14/2016, 24 mars 2016, E. Rev. nr. 06/2015, 19 mars 2015, E. Rev. nr. 55/2014, 3 nëntor 2014 dhe E. Rev. nr. 20/2014, 14 prill 2014.

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

Neni 281
Subrogimi ligjor

Kur detyrimin e përmbush personi i cili ka ndonjë interes juridik në këtë çështje, atëherë i kalojnë këtij, në bazë të vet ligjit, në çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore.

Neni 382
Kamatëvonesa

1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën.

2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

LIGJI NR. 04/L-018 PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGJEGJËSIA

Neni 26

Procedura e kërkesave për dëmshpërblim

1. Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me:
1.1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse;
1.2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit.

2. Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e kompletuar me prova dhe dokumentacion të nevojshëm për të vendosur për dëmshpërblimin, siguruesi është i detyruar që, më së largu në afat prej tri (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për dëmshpërblim, të njoftojë me shkrim të dëmtuarin duke precizuar me cilat nga provat dhe dokumentacioni duhet plotësuar kërkesën. Prej ditës së pranimit, respektivisht kompletimit të dokumentacionit të kërkesës, fillojnë të zbatohen afatet nga paragrafi 1. i këtij neni për detyrimin e siguruesit përkitazi me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.

3. BQK-ja nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e procedurave për dëmshpërblim, duke përfshirë edhe përcaktimin se kur konsiderohet e kompletuar kërkesa me prova dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vendosur lidhur me dëmshpërblimin.

4. Në pamundësi të përcaktimit të dëmit, respektivisht trajtimit të dëmshpërblimit në tërësi, siguruesi përgjegjës është i detyruar t'i paguajë palës së dëmtuar pjesën jokontestuese të dëmit në formë paradhënie, brenda afatit nga paragrafi 1. i këtij neni.

5. Në rast se siguruesi përgjegjës nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në Gjykatën Kompetente.

6. Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

7. Dispozitat nga paragrafi 1., 2., 4. dhe 5. të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në rastet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim të cilat janë detyrim i byrosë për dëmet nga baza e sigurimit kufitar dhe detyrimet e Fondit të kompensimit.
8. Në kërkesat për dëmshpërblim nga sistemi i kartonit ndërkombëtar të sigurimit zbatohen procedura dhe afate të posaçme sipas Marrëveshjes së Kretës.

Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë i miratuar nga Bordi Drejtues i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, më 25 shtator 2008

Neni 5.1
Rregullimi i dëmeve

Kërkesat për zhdëmtim të bazuara në sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë në pajtim me dispozitat e kësaj rregulle, përfshirë regresin nga fondi garantues duhet të zgjidhen në një periudhë kohore prej 10 ditësh prej ditës së parashtrimit të provave të nevojshme dhe dokumentacionit relevant që kërkohen nga kompania e sigurimit apo fondit garantues, duke iu referuar zhdëmtimit të dëmeve që kanë për pasojë vdekjen, lëndime trupore apo humbjen e pasurisë.

Fondi garantues apo një kompani e sigurimit e cila nuk rregullon dëmin valid Brenda periudhës kohore prej dhjetë (10) ditësh, duhet të paguaj dënimin e barabartë me 20% të kamatës vjetore të llogaritur nga data e raportimit të dëmit deri në datën kur zhdëmtimi është paguar apo rregulluar.

Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, i cili në nenin 14 parasheh mekanizmin për administrimin e drejtë të drejtësisë dhe shqyrtimin e ndryshimit të praktikës gjyqësore.

Neni 14
Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryetarit dhe nënkryetarit të Gjykatës

"[...]
2.10. Kryetari i gjykatës thërret takim vjetor të të gjithë gjyqtarëve për këshillim mbi Administrimin e Drejtësisë në atë gjykatë; për të analizuar organizimin e gjykatës; për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika".

Mendim Juridik për Kamatën i miratuar në mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, më 1 dhjetor 2020

PJESA E PARË: Ligji i aplikueshëm:

I. *Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85, 57/89).*

II. *Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 19.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 19/19, datë 19.06.2012.*

III. *Për kërkesat periodike të cilat kanë lindur nga marrëdhëniet e detyrimeve para datës 20.12.2012, por të cilat shtrihen (arrijnë për pagesë) edhe në periudhë pas datës 19.12.2012, ndërsa gjykata për çështjen objekt kontesti sipas padisë vendos pas datës 19.12.2012, atëherë ligj i zbatueshëm është:*

-për kërkesat periodike që kanë arritur për pagesë deri më datën 20.12.2012, lidhur me kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85, 57/89);

-për kërkesat periodike që arrijnë për pagesë pas datës 19.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji nr. 04/L-077.

PJESA E DYTË: Shkalla/lartësia e kamatës:

IV. *Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës caktohet si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar. [...]*

VI. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 19.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore për të gjitha kërkesat do të caktohet në lartësi prej 8%, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.
[...]

XI. Për rastet e kërkesave për kompensim të dëmit apo mbulimit të shpenzimeve për rastin e siguruar (kompensimin e rastit të siguruar) me policë vullnetare (sigurim vullnetarë), lartësia e kamatës caktohet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik, varësisht se cili ligj është në zbatim në kohën kur paraqitet rasti i siguruar.

Përjashtimet nga ***pika IV (katër),*** *V (pesë),* ***VI (gjashtë),*** *VII (shtatë), VIII (tetë), IX (nëntë) dhe X (dhjetë) për lartësinë e kamatës.*

XII. Për kërkesat e ***palëve të treta*** *ndaj* ***Kompanive të Sigurimeve****, kamata* ***në lartësi prej 12%*** *të interesit vjetor zbatohet llogaritet kur plotësohen kushtet ligjore, në rastet e mosrespektimit të afateve (neni 26, paragrafi 1 dhe 2 Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011) dhe mos- përmbushjes së detyrimit (neni 26, paragrafi 4, i ligjit të njëjtë) nga ana e siguruesve përgjegjës (Kompanitë e Sigurimeve) për çdo ditë vonese deri në shlyerjen e detyrimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.*

Situatat kur aplikohet norma e interesit vjetor prej 12 %:
-Kur kërkesat e paraqitura tek Kompanitë e Sigurimeve, për dëmin në persona, nuk trajtohen në afat prej 60 ditësh;
-Kur kërkesat e paraqitura tek Kompanitë e Sigurimeve, për dëmin në pasuri, nuk trajtohet brenda 15 ditësh;
-Në pamundësi të përcaktimit të dëmit, respektivisht trajtimit të dëmshpërblimit në tërësi, siguruesi përgjegjës është i detyruar t'i paguaj palës së dëmtuar pjesën jokontestuese të dëmit në formë paradhënie, brenda aftit prej 60 ditësh për dëmin në persona dhe 15 ditësh për dëmin në pasuri.

XIII. Për pagesat në vonesë të debitorëve ndaj kreditoreve-institucioneve financiare, kredidhënëse, kamatëvonesa do të llogaritët në procedurën e përcaktuar me akte nënligjore nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), sipas normës/lartësisë së përcaktuar me kushte dhe afatet e marrëveshjes përkatëse të instrumentit kreditor, ndaj institucionit financiar përkatës.

Arsyetimi për pikën I (një) të mendimit juridik *- Është standard i së drejtës civile që ligji material do të vlej në kohë të caktuar dhe territor të caktuar. Në këtë kontekst përcaktohet edhe zbatimi i dispozitave të Ligjit mbi/për Marrëdhëniet e Detyrimeve, duke marrë si bazë kohën e lindjes së marrëdhënieve juridike civile. Në praktikë është paraqitur si dilemë, dhe në disa raste është zbatuar në mënyrë të gabuar dispozita e ligjit i cili nuk ka qenë në fuqi në kohen e lindjes së marrëdhënies juridike civile. [...]*

Arsyetimi për pikën IX (nëntë) të mendimit juridik - *Në praktikën gjyqësore paraqiten raste të shpeshta të kreditorëve për rimbursim të dëmit të cilët kanë përmbushur detyrimet paraprakisht ndaj palëve të treta, e të cilat kryesisht ndërlidhen me rastet e siguruara nga kompanitë e sigurimeve vendore me kompanitë e huaja. Për këtë lloj të kërkesave në praktikën e gjykatave është vërejtur interpretim dhe zbatim i dispozitave ligjore në disa forma sa i përket shkallës/lartësisë së kamatëvonesës për rastet e kërkesave për rimbursim. Kjo ka ndodhur për shkak se kreditorët me rastin e paraqitjes së kërkesave për rimbursim të dëmit duke iu referuar nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, nr. 04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, kanë kërkuar që rimbursimi i kërkesës të bëhet me normë vjetore prej 12%, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës në Seancën e Përgjithshme të saj përmes këtij mendimi juridik ka vlerësuar se nuk mund të aplikohet norma/kamatëvonesa vjetore prej 12% në të gjitha rastet. Kjo për shkak se kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit kryesisht u referohen situatave për marrëdhëniet juridiko-civile (jokontraktuale për kreditorin dhe debitorin), prandaj, në një rast të tillë sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kamatëvonesa vjetore duhet të paguhet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik. Kjo nënkupton se në rast se kreditori ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë, para datës 20.12.2012, norma e interesit do të zbatohet si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, ndërsa në rast se kreditori ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë pas datës 19.12.2012, atëherë shkalla/lartësia e kamatëvonesës do të zbatohet në shkallë prej 8%.*

Përveç të cekurave Gjykata Supreme vlerëson se shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore prej 12%, nuk mund të zbatohet edhe për shkak të faktit se sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në

Gazetën Zyrtare me nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, interesi vjetor 12%, vjen në shprehje për shkak të neglizhencës së kompanive të sigurimeve (të cilat pastaj paraqiten si kreditor regresues), sepse sikur kreditorët regresues t'i kishin trajtuar konform përgjegjësive ligjore kërkesat e palëve të treta, ndaj tyre nuk do të mund të zbatohej shkalla/lartësia e kamatëvonesës prej 12%, në vendimet e gjykatës, por do të zbatohej shkalla/lartësia si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, apo shkalla/lartësia prej 8%, varësisht se cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e lindjes së marrëdhënies së detyrimit.

Pranueshmëria e kërkesës

39. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

[...]

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

[...]
"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

41. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesja e kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht…".

42. Në vlerësimin e përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të saj, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih, rastet e Gjykatës KI118/18, parashtrues, *Eco Construction sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019, paragrafi 29; dhe KI41/09, Parashtrues, *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14). Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar që konteston akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme E. Rev. nr. 62/2020, të 6 prillit 2020, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të parashikuara me ligj.

43. Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 62/2020, i 6 prillit 2020, i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 18 maj 2020 derisa kërkesa nën shqyrtim është dorëzuar më 14 korrik 2020, pra, brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

44. Gjykata po ashtu konsideron se parashtruesja e kërkesës ka treguar saktësisht se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj janë shkelur në dëm të saj, në pajtim me kriteret e parashikuara nga neni 48 i Ligjit.

45. Prandaj, Gjykata vjen në përfundim se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike; se e ka respektuar kushtin e dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor; i ka sqaruar me saktësi shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe ka treguar cili është akti konkret i autoritetit publik që kontestohet.

46. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe argumentimit të tyre, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze kushtetuese dhe përcaktimi i tyre varet nga shqyrtimi i meritave të kërkesës. Po ashtu, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme (shih Gjykata Kushtetuese Rasti nr. KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017).

47. Gjykata shpall kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita.

Meritat e kërkesës

48. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, për shkak se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk ofron arsyetim të mjaftueshëm dhe adekuat lidhur me ndryshimin e qëndrimit përkitazi me llogaritjen e kamatëvonesës, qëndrim të cilin, sipas parashtrueses së kërkesës Gjykata Supreme deri atëherë e kishte zbatuar në mënyrë konsistente në praktikën e saj. Për më tepër, parashtruesja pretendon se Gjykata Supreme nuk ka vendosur në pajtim me gjetjet e Gjykatës Kushtetuese sipas Aktgjykimit KI87/18, të 27 shkurtit 2019.

49. Gjykata vlerëson se në rastin konkret pretendimet për mosarsyetim të vendimit gjyqësor dhe moszbatim të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe të GjEDNj-së, për shkak të natyrës së rastit dhe ndërlidhjes së tyre, do t'i trajtojë në kuadër të një arsyetimi të vetëm.

50. Në dritën e këtyre sqarimeve, Gjykata do të shqyrtojë në vazhdim pretendimin e parashtrueses së kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së.

51. Në këtë drejtim, Gjykata i rikujton përmbajtjen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."*

52. Përveç kësaj, Gjykata i rikujton gjithashtu përmbajtjen e nenit 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, i cili përcakton:

> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ...".*

53. Gjykata rithekson se në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në pajtim me praktikën gjyqësore të GjEDNj-së. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së, përkatësisht lidhur me të drejtën për vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GjEDNj-së.

Parimet e përgjithshme për të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor

54. Gjykata, para së gjithash, rikujton se garancitë e përmbajtura në nenin 6. paragrafin 1 të KEDNj-së përfshijnë detyrën e gjykatave që të bëjnë arsyetimin e vendimeve të tyre. Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë (shih Aktgjykimin e

GjEDNj-së *H. kundër Belgjikës,* kërkesa 8950/80, paragrafi 53, të 30 nëntorit 1987).

55. Gjykata, gjithashtu, thekson se sipas praktikës së GjEDNj-së, neni 6. paragrafi 1 i detyron gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga gjykatat të kërkohet përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GjEDNj-së, *Van de Hurk kundër Holandës,* Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, [DHM], paragrafi 81.).

56. Lidhur me këtë, GjEDNj shton se gjykata vendore ka një liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e pretendimeve dhe në lejimin e provave, por ajo gjithashtu ka edhe obligimin që të justifikojë veprimet e saj duke dhënë arsyetime për vendimet e saj (shih Aktgjykimin e GjEDNj-së *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa 37801/97, të 1 korrikut 2003, paragrafi 36).

57. Gjithashtu, Gjykata thekson se në pajtim me praktikën e GjEDNj-së, gjatë shqyrtimit nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i plotëson standardet e të drejtës për gjykim të drejtë, duhet të merren parasysh rrethanat e rastit konkret. Vendimi gjyqësor nuk duhet të jetë pa asnjë arsyetim, as arsyetimi nuk duhet të jetë i paqartë. Kjo posaçërisht vlen për arsyetimin e vendimit të gjykatës e cila vendos sipas mjetit juridik, në të cilin janë ndryshuar qëndrimet juridike të paraqitura në vendimin e gjykatës më të ulët (shih rastin e GjEDNj-së, *Van de Hurk kundër Holandës,* Aktgjykimi i 19 prillit 1994, paragrafi 61).

58. Gjykata dëshiron të theksojë se nocioni i një gjykimi të drejtë, në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, gjithashtu kërkon që gjykata kombëtare e cila ka dhënë arsye të pakta për vendimet e saj, në të vërtetë të ketë adresuar çështjet themelore në kuadër të juridiksionit të saj, pra se nuk i kishte pranuar thjeshtë dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët. Kjo kërkesë është edhe më e rëndësishme në rast kur një palë në kontest nuk ka pasur mundësi për të paraqitur gojarisht rastin e saj në procedurën vendore (shih Aktgjykimin e GjEDNj-së *Helle kundër Finlandës,* kërkesa 157/1996/776/977, të 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60).

59. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe reflektimeve kur shqyrtohet prova e propozuar, nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të

ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI96/16 *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017).

Zbatimi i parimeve të përmendura për të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor në rrethanat e rastit konkret

60. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit E. Rev. nr. 62/2020 të Gjykatës Supreme, duke pretenduar se i njëjti *"sërish karakterizohet nga mungesa e arsyetimit adekuat, sepse Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetime të mjaftueshme dhe adekuate përkitazi me ndryshimet e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ae. nr. 191/2017, të 31 tetorit 2017, në lidhje me kamatëvonesën, duke shkelur kësisoj parimin e ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje"*.

61. Tuje, parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme në arsyetimin e Aktgjykimit të kontestuar, vetëm se ka listuar vërejtjet nga Aktgjykimi KI87/18 i Gjykatës Kushtetuese dhe nuk i është përmbajtur rekomandimeve të saj. Në thelb dhe për pasojë, parashtruesja e kërkesës pretendon se arsyetimi i Aktgjykimit të kontestuar rezulton të këtë të njëjtat mangësi, sepse përmban arsyetim të pamjaftueshëm, gjegjësisht mungesë të justifikimit dhe shpjegimeve objektive.

62. Në thelb, parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar, vetëm përkitazi me pikën 2 (dy) të dispozitivit, në lidhje me kamatëvonesën, duke e ndërlidhur sërish me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së, përkatësisht me të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor.

63. Prandaj, duke pasur parasysh pretendimin kryesor ankimor të parashtrueses së kërkesës, Gjykata konsideron se duhet të analizohet nëse Gjykata Supreme, ka dhënë arsye të qarta dhe të mjaftueshme mbi të cilat e ka mbështetur vendimin e saj për ndryshimin e aktgjykimeve të instancave më të ulëta, lidhur me lartësinë e normës se interesit/kamatëvonesës.

64. Së pari, Gjykata rikujton se në rastin e saj KI87/18, ajo konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së për shkak të pamjaftueshmërisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, si rrjedhojë edhe të moskonsistencës së Gjykatës Supreme në vendimmarrje përkitazi me aplikimin e normave të interesit.

65. Në vazhdim, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të kontestuar, për të vlerësuar nëse Gjykata Supreme, ka eliminuar shkaqet që çuan në shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson nëse Gjykata Supreme e justifikon ndryshmin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në pikën 2 (dy) të dispozitivit dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, në pikën 1 (një) të dispozitivit, përkitazi me ndryshimin e lartësisë së kamatëvonesës.

66. Arsyetimi i Gjykatës Supreme në këtë pikë, thekson: *"Gjykata Supreme ka bërë unifikimin e praktikës gjyqësore në rastet e caktimit të lartësisë së kamatës, në kontest për subrogim të borxhit, duke konkluduar se në kontestet për subrogim të dëmit ligjërisht nuk aplikohet kamatëvonesa e përcaktuar me nenin 26.6 të Ligjit për Sigurimet e Detyrueshme nga Autopërgjegjësia (pavarësisht faktit nëse ligji ka qenë në fuqi). Andaj, Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e këtillë e çështjes vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale me pranimin e kamatës 12%, në kontestet për subrogim të borxhit ashtu si është rasti konkret. Kjo për faktin se kjo shkallë e kamatës aplikohet, por vetëm në kërkesat e personave të dëmtuar për shpërblimin e dëmit në procedurën jashtëgjyqësore, ashtu siç parashihet në nenin 26 të Ligjit në fjalë dhe nenit 5.1 të Rregullit të BQK-së, nr. 3 Mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e detyrueshëm nga Autopërgjegjësia të datës 25 shtator 2008, në të cilat dispozita thirren gjykatat e instancës së ulët".*

67. Tutje, Gjykata Supreme thekson se: *"Kamata e aplikuar nga gjykatat e instancës me të ulët është paraparë me qëllim të disiplinimit të kompanive siguruese në raportet e sigurimit ndaj kërkesave për dëmshpërblim të personave të dëmtuar të cilat kërkesa kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që t'i trajtojnë me urgjencë brenda afateve të parapara sipas dispozitave të lartpërmendura. Paragrafi 7 i nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga Autopërgjegjësia përjashton zbatimin e kamatës 12% për subrogim e borxhit, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtimin dhe rënie në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim".*

68. Si konkluzion, Gjykata Supreme arsyetoi: *"Nga kjo rezulton se paditësja* (parashtruesja e kërkesës) *ka të drejtën vetëm në kamatëvonesë dukë marrë për bazë lartësinë që paguajnë bankat afariste në Kosovë, në mjetet e deponuara dhe pa destinim të caktuar mbi një vit, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 277 të LMD-së, e jo edhe kamatë të kualifikuar sipas dispozitës të zbatuar nga gjykatat e instancës me të ulët. Meqenëse paditësja me parashtresën e datës 19 tetor 2010, ka kërkuar subrogim të borxhit nga e paditura rezulton se e paditura nga kjo datë ka rënë në vonesë kur nuk e ka përmbushur detyrimin brenda afatit deri në pagesën definitive".*

69. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e kontestuar, ka dhënë arsye bindëse dhe të mjaftueshme duke shtjelluar në detaje bazën ligjore mbi të cilën e ka mbështetur ndryshimin e lartësisë së normës së interesit (kamatëvonesës) në pikën 2 (dy) të dispozitivit, duke arsyetuar në mënyrë logjike se përse në rrethana të këtilla parashtrueses së kërkesës nuk mund t'i akordohet norma e interesit prej 12%, në bazë të nenit 26.6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

70. Në këtë kuptim, Gjykata Supreme, ka arsyetuar se neni 26.6 i Ligjit në fjalë, zbatohet vetëm në rastet kur rënia në vonesë për shlyerjen e detyrimit (dëmshpërblimit) bëhet me kërkesë të personave të dëmtuar. Tutje, Gjykata Supreme arsyetoi, se në rrethanat e rastit konkret nuk kemi të bëjmë me kërkesë për dëmshpërblim nga personi i dëmtuar, por me kërkesë për rënien në vonesë të shlyerjes së detyrimit nga kompania vendore e sigurimeve SIGMA, ndaj parashtrueses së kërkesës, andaj në këtë kuptim Gjykata Supreme ka arsyetuar se perse paragrafi 6 i nenit 26 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia nuk zbatohet për parashtruesen e kërkesës por paragrafi 7 i nenit 26 i të njëjtit Ligj.

71. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës edhe më tutje mund të mos jetë e kënaqur me arsyetimin dhe bazën ligjore të zbatuar nga Gjykata Supreme. Megjithatë, në praktikën e saj gjyqësore në mënyrë konsistente Gjykata ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit bien brenda fushëveprimit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë antikushtetuese (shih, mes tjerash, Gjykata Kushtetuese rasti nr. KI33/16, parashtruese *Minire Zeka*, Aktgjykim i 4 gushtit 2018, paragrafi 91).

72. Për më tepër, Gjykata gjen se vendimmarrja e Gjykatës Supreme, në rrethanat faktike dhe juridike të rastit konkret është në pajtueshmëri edhe me mendimin juridik të nxjerrë nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, e 2 dhjetorit 2020. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton arsyetimin e mendimit juridik në pikën nëntë (IX), ku Gjykata Supreme arsyeton, si në vijim:

> ***Arsyetimi për pikën IX (nëntë) të mendimit juridik -*** *Në praktikën gjyqësore paraqiten raste të shpeshta të kreditorëve për rimbursim të dëmit të cilët kanë përmbushur detyrimet paraprakisht ndaj palëve të treta, e të cilat kryesisht ndërlidhen me rastet e siguruara nga kompanitë e sigurimeve vendore me kompanitë e huaja. Për këtë lloj të kërkesave në praktikën e gjykatave është vërejtur interpretim dhe zbatim i dispozitave ligjore në disa forma sa i përket shkallës/lartësisë së kamatëvonesës për rastet e kërkesave për rimbursim. Kjo ka ndodhur për shkak se kreditorët me rastin e paraqitjes së kërkesave për rimbursim të dëmit duke iu referuar nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, kanë kërkuar që rimbursimi i kërkesës të bëhet me normë vjetore prej 12%, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës në Seancën e Përgjithshme të saj përmes këtij mendimi juridik ka vlerësuar se nuk mund të aplikohet norma/kamatëvonesa vjetore prej 12% në të gjitha rastet. Kjo për shkak se kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit kryesisht u referohen situatave për marrëdhëniet juridiko-civile (jokontraktuale për kreditorin dhe debitorin), prandaj, në një rast të tillë sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kamatëvonesa vjetore duhet të paguhet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik. Kjo nënkupton se në rast se kreditori ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë, para datës 20.12.2012, norma e interesit do të zbatohet si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, ndërsa në rast se kreditori ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë pas datës 19.12.2012, atëherë shkalla/lartësia e kamatëvonesës do të zbatohet në shkallë prej 8%.*
>
> *Përveç të cekurave Gjykata Supreme vlerëson se shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore prej 12%, nuk mund të zbatohet edhe për shkak të faktit se sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare me nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, interesi vjetor 12%, vjen në*

shprehje për shkak të neglizhencës së kompanive të sigurimeve (të cilat pastaj paraqiten si kreditor regresues), sepse sikur kreditorët regresues t'i kishin trajtuar konform përgjegjësive ligjore kërkesat e palëve të treta, ndaj tyre nuk do të mund të zbatohej shkalla/lartësia e kamatëvonesës prej 12%, në vendimet e gjykatës, por do të zbatohej shkalla/lartësia si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, apo shkalla/lartësia prej 8%, varësisht se cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e lindjes së marrëdhënies së detyrimit.

73. Në këtë kuptim, Gjykata vë në pah faktin se Gjykata Supreme, si instancë më e lartë e gjyqësorit të rregullt, ka përmbushur detyrimin e saj ligjor dhe kushtetues, duke unifikuar praktikën gjyqësore përmes nxjerrjes së një akti parimor (mendimit juridik), të cilin detyrohen ta zbatojnë të gjitha nivelet e instancave gjyqësore, përfshi vetë Gjykatën Supreme. Ky akt juridik eviton probabilitetin e shkeljes së të drejtës në gjykim të drejtë përkatësisht të parimit të sigurisë juridike.

74. Në këtë këndvështrim, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme, në përputhje me kërkesat e nenit 14 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, ka krijuar një mekanizëm efektiv, i cili shmangë devijimet e mundshme nga praktika gjyqësore konsistente, për çështje të njëjta faktike dhe juridike, devijime të cilat sipas konstatimeve të Gjykatës Kushtetuese kanë çuar në shkeljen e parimit të sigurisë juridike, të sundimit të ligjit, të miradministrimit të drejtësisë dhe të humbjes së besimit të publikut ndaj gjyqësorit.

75. Prandaj, ky mendim juridik i Gjykatës Supreme është në pajtueshmëri edhe me kriteret e përcaktuara të GjEDNj-së, përmes së cilave identifikohen divergjencat (kundërthëniet) në vendimmarrje për çështje të njëjta faktike dhe juridike, siç janë: (i) dallimet e thella dhe afatgjata në praktikën gjyqësore, (ii) përcaktimi nëse ligjet e vendit parashohin një mekanizëm i cili i tejkalon këto kundërthënie, dhe (iii) përcaktimin nëse ky mekanizëm është zbatuar dhe, nëse po, deri në çfarë mase, në mënyrë që vendimmarrja e gjykatave vendore të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e gjykimit të drejtë, siç kërkon neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së.

76. Gjykata, nga të gjitha shtjellimet e sipërtheksuara, në rrethanat e rastit konkret, konsideron se parashtruesja e kërkesës thjeshtë është e pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë Gjykatës Supreme. Megjithatë, pakënaqësia e saj nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNj-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

77. Për më tepër, Gjykata konstaton se të gjitha vërejtjet e dhëna nga Gjykata në Aktgjykimin e saj të 27 shkurtit 2019 (rasti KI87/18), për sa i përket arsyetimit të pikës 2 (dy) të Aktgjykimit të kontestuar, se mbi cilën bazë ligjore a ligj e kishte mbështetur Gjykata Supreme ndryshimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit përkitazi me lartësinë e normës së interesit (kamatëvonesës), tashmë janë konsumuar sepse Aktgjykimi i kontestuar, përmban arsyetim logjik dhe sqaron me saktësi se përse në rastin e parashtrueses së kërkesës nuk mund të aplikohet norma në lartësinë prej 12%, duke theksuar se kjo normë e interesit aplikohet vetëm kur kërkesat për dëmshpërblim bëhen nga personat të dëmtuar kërkesa të cilat kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që t'i trajtojnë me urgjencë brenda afateve të parapara sipas dispozitave të nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Përveç kësaj, Gjykata thekson se është konsumuar dhe pretendimi për moskonsistencë në vendimmarrje, përmes nxjerrjes së mendimit juridik nga ana e Gjykatës Supreme. Kësisoj janë eliminuar edhe shkaqet të cilat kanë shkaktuar pasiguri juridike për shkak të zbatimit jo uniform të praktikës gjyqësore për çështje faktike dhe juridike të njëjta.

78. Prandaj, Gjykata konstaton se në rastin e parashtrueses se kërkesës nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përfundim

79. Si përmbledhje, lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor, Gjykata konkludon se Gjykata Supreme: (i) ka dhënë bazën juridike dhe ka shpjeguar me qartësi se përse në rastin e parashtrueses së kërkesës nuk zbatohet norma e interesit prej 12%; (ii) Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmban lidhje logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe përfundimeve të nxjerra; (iii) si rrjedhojë logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe përfundimeve ka rezultuar se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, E. Rev. 62/2020, e plotëson kushtin e një vendimi të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor.

80. Andaj, Gjykata konkludon se, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 prill 2021,

VENDOS

I. TË DEKLAROJË, njëzëri kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i Republikës së Kosovës, E. Rev. nr. 62/2020, i 6 prillit 2020 është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

IV. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi

KI186/19, KI187/19, KI200/19 dhe KI208/19, Parashtrues: Belkize Vula Shala dhe të tjerët, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019

KI186/19, KI187/19, KI200/19 dhe KI208/19, Aktgjykim i 28 prillit 2021, i publikuar më 1 qershor 2021

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, mungesa e seancës dëgjimore, shkelje e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me privatizimin e Ndërmarrjes N.Sh. "Agimi" në Gjakovë dhe të drejtat respektive të punëtorëve për t'iu njohur statusi i punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga ky privatizim, siç është përcaktuar në nenin 68 (Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime) të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe paragrafin 4 të nenit 10 (Të Drejtat e të Punësuarëve) të Rregullores nr. 2003/13 e të ndryshuar me Rregulloren nr. 2004/45.

Parashtruesit e kërkesës nuk u përfshinë në Listën e Përkohshme të punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi". Të njëjtit në mënyrë individuale parashtruan ankesa pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Këto ankesa u refuzuan. Për pasojë, parashtruesit e kërkesës iniciuan padi në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, duke kontestuar Vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, përkitazi me vërtetimin e fakteve si dhe interpretimin e ligjit, duke pretenduar gjithashtu se ishin diskriminuar. Të gjithë parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore para Kolegjit të Specializuar.

Kolegji i Specializuar, kishte refuzuar kërkesën për seancë dëgjimore me arsyetimin se "faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaft të qarta", duke u dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës, me përjashtim të dy prej tyre, dhe duke konstatuar se ishin diskriminuar, prandaj të njëjtit duhet të përfshihen në Listën Përfundimtare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Duke vepruar mbi bazën e ankesës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit kundër këtij Aktgjykimi, në gusht të vitit 2019, Kolegji i Apelit, kishte nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar, përmes të cilit kishte miratuar ankesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe e kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, duke hequr "nga lista e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të NSH-së "Agimi" Gjakovë" të gjithë parashtruesit e kërkesës. Këtë Aktgjykim, parashtruesit e kërkesës e kontestojnë para Gjykatës, duke pretenduar se i

njëjti është nxjerrë në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përkitazi me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashtruesit e kërkesës, pretendojnë se Kolegji i Apelit ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, (i) pa një seancë dëgjimore; (ii) pa arsyetim të mjaftueshëm; (iii) në interpretim arbitrar të ligjit; dhe (iv) në shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata u fokusua në ato që ndërlidhen me mungesën e një seancë dëgjimore para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, dhe në këtë kontekst, (i) fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore siç është e garantuar përmes Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe më pas, (ii) aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata, duke u bazuar ndër të tjerash, në Aktgjykimin të Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë, sqaroi parimet kryesore që kanë të bëjnë me (i) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë; (ii) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë dhe të tretë; (iii) parimet në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme; dhe (iv) nëse mungesa e dëgjimit në shkallën e parë mund të korrigjohet përmes një seance dëgjimore në një shkallë më të lartë dhe kriteret përkatëse për të bërë këtë vlerësim. Për më tepër, Gjykata në mënyrë specifike shqyrtoi dhe aplikoi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut bazuar mbi të cilën bëhet vlerësimi nëse mungesa e një kërkese për seancë dëgjimore, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar e palëve nga një e drejtë e tillë.

Pas aplikimit të këtyre parimeve, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019 i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore, ndër të tjerash, sepse (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tyre nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtojë me nismën e tij domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore; (ii) parashtruesve të kërkesës iu është mohuar e drejta e seancës dëgjimore në të dy nivelet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme; (iii) Kolegji i Apelit, nuk kishte

trajtuar "çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike", çështje këto bazuar në të cilat do të mund të kishin ekzistuar "rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore"; (iv) Kolegji i Apelit, në fakt, kishte shqyrtuar çështje "fakti dhe ligji", çështje këto shqyrtimi i të cilave, në parim, kërkon mbajtjen e një seance dëgjimore; dhe (v) Kolegji i Apelit, nuk kishte arsyetuar "heqjen dorë nga seanca gojore".

Për pasojë, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme, duhet të shpallet i pavlefshëm, dhe të kthehet në rivendosje në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Gjykata gjithashtu vuri theksin në faktin se konstatimi i saj për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet ekskluzivisht me mungesën e një seance dëgjimore, dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

Në lidhje me rastin KI208/19 ku parashtrues ishte Ethem Bokshi, Gjykata nuk e shqyrtoj atë kërkesë, për arsye se Gjykata veç se kishte vendosur lidhur me këtë parashtrues në rastin KI145/19.

AKTGJYKIM

në

rastet nr. KI186/19, KI187/19, KI200/19 dhe KI208/19

Parashtrues

Belkize Vula Shala dhe të tjerët

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa KI186/19 është dorëzuar nga Belkize Vula Shala, me banim në Gjakovë; Kërkesa KI187/19 është dorëzuar nga Agim Buza, me banim në Gjakovë; Kërkesa KI200/19 është dorëzuar nga Shkendije Shehu, me banim në Gjakovë; Kërkesa KI208/19 është dorëzuar nga Ethem Bokshi me banim në Gjakovë;(në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë

Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 (Procedimi i kërkesës) dhe nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 tetor 2019, parashtruesit Belkize Vula Shala dhe Agim Buza i dorëzuan përmes postës kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 nëntor 2019, parashtruesja e kërkesës Shkëndije Shehu e dorëzoi përmes postës kërkesën në Gjykatë.

7. Më 20 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës Ethem Bokshi dorëzoi përmes postës kërkesën e tij në Gjykatë.

8. Më 29 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi për rastin KI186/19 gjyqtaren Selvete Gërxhaliu Krasniqi Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

9. Më 29 tetor 2019, në pajtim me rregullin 1 të rregullit 40 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së Punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI187/19 me kërkesën KI186/19.

10. Më 5 nëntor 2019, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesave KI186/19 dhe KI187/19 dhe DHPGJS për regjistrimin dhe bashkimin e tyre.

11. Më 12 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI200/19 me kërkesat KI186/19 dhe KI187/19.

12. Më 19 nëntor 2019, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës KI200/19 si dhe DHPGJS për regjistrimin e kërkesës dhe bashkimin e saj me kërkesat KI186/19 dhe KI187/19.

13. Më 19 dhjetor 2019, Gjykata kërkoi sqarim nga ana e parashtruesit të kërkesës KI208/19, për shkak se i njëjti vetëm kishte dorëzuar një kërkesë të mëhershme të regjistruar me nr. KI145/19. Mirpo i njëjti nuk i ishte përgjigjur kërkesës së Gjykatës.

14. Në lidhje me rastin KI208/19 ku parashtrues është Ethem Bokshi, Gjykata nuk do të shqyrtojë këtë kërkesë, për arsye se Gjykata veç ka vendosur lidhur me këtë parashtrues në rastin KI145/19.

15. Më 28 prill 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

16. Në të njëjtën ditë, Gjykata me shumicë konstatoi se (i) kërkesa është e pranueshme; dhe me shumicë konstatoi se (ii) Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019 i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 15 shtator 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin në vijim: AKP) kishte privatizuar ndërmarrjen shoqërore NSH "Agimi" në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: NSH "Agimi"). Në të njëjtën datë, përmes shkresës [nr.1065], parashtruesit e kërkesës ishin njoftuar se "*pasoja shitjes së aseteve kryesore është përfundimi i punësimit tuaj*" dhe se i njëjti "*përfundon menjëherë*". Të gjithë parashtruesit e kërkesës ishin punëtorë të ndërmarrjes përkatëse në intervale të caktuara kohore.

18. Bazuar në shkresat e lëndës dhe duke marrë parasysh që parashtruesit e kërkesës nuk ishin pjesë e Listës së Përkohshme të punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet

përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH ”Agimi”, të njëjtit në mënyrë individuale parashtruan ankesa pranë AKP-së. Kjo e fundit, më 13 dhjetor 2011, refuzoi si të pabazuara ankesat përkatëse.

19. Më 22 dhjetor 2011, përmes mjeteve të informimit publik: (i) u publikua Lista e Përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH ”Agimi” (në tekstin e mëtejmë: Lista Përfundimtare); si dhe (ii) u përcaktua 14 janari 2012 si datë e fundit për dorëzimin e ankesave në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS) kundër Listës Përfundimtare.

20. Ndërmjet 28 dhjetorit 2011 dhe 13 janarit 2012, parashtruesit e kërkesës në mënyrë individuale parashtruan ankesë në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, për shkak të mospërfshirjes në Listën Përfundimtare. Në parim, të gjithë kishin pretenduar se nuk ishin trajtuar në mënyrë të barabartë me punëtorët e tjerë që ishin përfshirë ne Listën Përfundimtare, dhe rrjedhimisht ishin diskriminuar.

21. Ndërmjet 1 marsit 2012 dhe 18 prillit 2012, AKP paraqiti përgjigje në ankesat e parashtruesve të kërkesës, duke theksuar se parashtruesit përkatës nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 (Të drejtat e të punësuarve) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi Transformimin e të Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore (në tekstin në vijim: Rregullorja nr. 2003/13), për arsye se (i) nuk kanë ofruar dëshmi për vërtetimin e kontinuitetit të marrëdhënies së punës; (ii) në kohën e privatizimit të ndërmarrjes, parashtruesit përkatës nuk ishin të regjistruar si punëtorë në NSH “Agimi”; dhe (iii) nuk i kanë mbështetur pretendimet për diskriminim.

22. Ndërmjet 3 prillit 2012 dhe 18 majit 2012, përmes përgjigjes në ankesën e AKP-së, disa nga parashtruesit e kërkesës, paraqitën shkresa me informata plotësuese lidhur me statusin e punëtorit në NSH “Agimi”, ku theksuan se (i) i gjithë “*dokumentacioni është në disponim të zyrtarëve të ndërmarrjes*”; dhe (ii) kërkuan mbajtjen e një seance dëgjimore.

23. Më 4 shtator 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin [SCEL-11-0075] përmes së cilit (i) në pikën II të dispozitivit miratoi si të bazuara ankesat e parashtruesve të kërkesës, Shkendije Shehu dhe Belkize Vula Shala, respektivisht, duke përcaktuar që të njëjtit duhet të përfshihen në Listën Përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi"; ndërsa (ii)

refuzoi si të pabazuara ankesat e ankuesve të cekur në pikën III, në këtë rast parashtruesit të kërkesës Agim Buza, respektivisht.

24. Kolegji i Specializuar përmes Aktgjykimit të lartcekur, fillimisht kishte përcaktuar se bazuar në paragrafin 11 të nenit 68 (Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime) të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Shtojca e Ligjit për DHPGJS-në), seanca dëgjimore nuk ishte e nevojshme sepse "*faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaftë të qarta*". Ndërsa, përkitazi me parashtruesit e kërkesës, ankesat e të cilëve ishin miratuar si të bazuara, Kolegji i Specializuar kishte theksuar se (i) parashtruesit përkatës, po të mos ishin diskriminuar, do t'i plotësonin kriteret e përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13, duke theksuar se "*të njëjtëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës gjate viteve 1990 dhe janë larguar nga puna duke u zëvendësuar me punëtor serb*", dhe se ky konstatim është pasojë e "*ngjarjeve botërisht të njohura pas vitit 1990 e në vazhdimësi*"; dhe (ii) në rastet kur pretendohet diskriminimi, bazuar në nenin 8 (Barra e provave) të Ligjit nr.2004/3 kundër Diskriminimit (në tekstin e mëtejmë: Ligji kundër Diskriminimit), i takon palës së paditur, përkatësisht AKP-së, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, dëshmi këto që nuk janë ofruar nga AKP. Në fund, përkitazi me refuzimin e ankesës të Agim Buzës , respektivisht, përmes pikës III të dispozitivit të Aktgjykimit përkatës, Kolegji i Specializuar kishte theksuar se të njëjtit nuk kishin dorëzuar dëshmi për shqyrtim dhe administrim siç parashihej me paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45 për Ndryshimin e Rregullores nr. 2003/13 Mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja nr. 2004/45).

25. Më 26 shtator 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktvendimin [SCEL-11-0075] përmes së cilit korrigjoi Aktgjykimin e lartcekur, pasi që kopja e dorëzuar e Aktgjykimit në gjuhën angleze ishte versioni preliminar dhe jo ai përfundimtar, përderisa versioni në gjuhën shqipe mbeti i pandryshuar.

26. Më 24 dhe 30 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës Agim Buza parashtroi ankesë individuale kundër pikës III të dispozitivit të Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duke pretenduar vlerësim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit përkatësisht paragrafit (j) të nenit 4 (Fusha e zbatimit të ligjit) të Ligjit kundër Diskriminimit dhe paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr.

2003/13. Ai pretendoi se është diskriminuar duke u trajtuar në mënyrë të pabarabartë me punëtorët e tjerë dhe të cilët janë përfshirë në Listën Përfundimtare. AKP-ja nuk ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit Agim Buza.

27. Më 30 shtator 2013, AKP parashtroi ankesë kundër pikës II të Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, përmes së cilit ishte miratuar ankesa e parashtrueseve të kërkesës Belkize Vula Shala dhe Shkëndije Shehu, respektivisht, duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që pika II e dispozitivit të këtij Aktgjykimi të anulohet. Sipas AKP-së asnjë ankues i cili me Aktgjykimin e atakuar është përfshirë në Listën Përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për marrjen e një pjese e të ardhurave prej njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi" nuk ka prezantuar fakte relevante në bazë të cilave kishte për ta vërtetuar faktin e trajtimit të pabarabartë dhe arsyetimin për diskriminim direkt apo të tërthortë në pajtim me paragrafin 1 të nenit 8 të Ligjit Kundër Diskriminimit.

28. Më 29 gusht 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008], përmes së cilit (i) duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 (Procedurat e ankesës me gojë) të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Ligji nr.06/L-086 për DHPGJS-në), Kolegji përkatës *"vendosi të heq dorë nga pjesa e seancës gojore"*; (ii) refuzoi si të pabazuar ankesën e Agim Buzës; ndërsa (ii) pranoi si të bazuar ankesën e AKP-së, përkitazi me parashtruesit e tjerë të kërkesës, përkatësisht Belkize Vula Shala dhe Shkëndije Shehu, duke përcaktuar se "*të njëjtit hiqen nga lista e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të NSH-së "Agimi" Gjakovë"*.

29. Përkitazi me parashtruesin Agim Buza, Kolegji i Apelit arsyetoi se (i) i njëjti nuk ka deponuar dëshmi për ta provuar kërkesën e tij; dhe (ii) nga libreza e punës rezulton se i njëjti është inkuadruar në pune më 1 janar 1990, ndërsa përfundimi i marrëdhënies së punës ka ndodhur më 30 shtator 1994, *"për shkak të fillimit të punës si ndërmarrës i pavarur"*.

30. Ndërsa, përkitazi me miratimin si të bazuar të ankesës së AKP-së, Kolegji i Apelit, ndër tjerash, theksoi se parashtruesit e kërkesës (i) me asnjë prove nuk e provojnë faktin se kanë qenë të punësuar në NSH "Agimi" apo se kanë qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes, kushte këto që kërkohen të plotësohen bazuar në

paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13, për t'u njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare të NSH "Agimi" për përftimin e njëzet përqindëshit (20%-it) nga shitja e ndërmarrjes; dhe se (ii) nuk pajtohet me konstatimin e Kolegjit të Specializuar lidhur me diskriminimin e punëtorëve përkatës *"sepse sipas praktikës së krijuar nga Dhoma e Posaçme sa i përket interpretimit të diskriminimit ky punëtor pasi është i nacionalitetit shqiptar nuk mund të ketë qenë i diskriminuar pas qershorit të vitit 1999"*.

31. Për sa i përket pretendimeve për diskriminim, Kolegji i Apelit gjithashtu theksoi se e "*drejta precedentale*" e DHPGJS-së, bazuar në Aktgjykimet [ASC-11-0069] dhe [AC-I-12-0012], përcakton që të diskriminuar mund të llogariten: (i) "*punëtorët e përkatësisë etnike shqiptare, apo që u takojnë minoriteteve ashkali, rome, egjiptian, goran dhe turq, të cilët ishin larguar për arsye diskriminimi në periudhën e ashtuquajtur të "masave të përkohshme serbe" (që sillet prej vitit 1989 deri në vitin 1999), apo të cilët u diskriminuan edhe në periudha të ndryshme, për shkak të etnisë së tyre, besimeve politike dhe religjioze, etj.*"; dhe (ii) "*punëtorët e përkatësisë etnike serbe të cilët për shkak të mungesës së sigurisë pas vitit 1999, nuk u paraqitën në punë dhe të njëjtit nuk u gjendën në listat përfundimtare të punëtorëve*".

32. Për më tepër, përkitazi me parashtruesen e kërkesës (i) Belkize Vula Shala, sqaroi se e njëjta kishte paraqitur si dëshmi kopjen e librezës së punës, "*nga e cila gjykata vërteton faktin se e njëjta ka filluar punën në NSH "Agimi" nga data 5 korrik 1983 ndërsa ka përfunduar me 31 janar 1995, po ashtu nga libreza e punës vërtetohet fakti se ankuesja nga 1 shkurti 1995 ka krijuar mardhënie të re të punës në PP "Marash Petrol" dhe e njejta është ende e hapur"* dhe se për pasojë, asaj nuk i takojnë të drejtat e pretenduara nga NSH "Agimi";[1] (ii) Shkëndije Shehu, sqaroi se e njëjta nuk ka bashkëngjitur asnjë provë për ti provuar faktet e pretenduara, dhe se "*ankuesja me asnjë provë nuk e provon faktin se ka themeluar apo vazhduar punën në NSH "Agimi", apo se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes, kushte këto që kërkohen të plotësohen nga ankuesit*

[1] Në Aktgjykimin AC-I-13-0181-A0008 të 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaqme, është vendos për dy parashtrues me të njejtin emër Belkize Vula Shala, ku për ankuesen me nr C-0024-02 Belkize Vula Shala, Kolegji I Apelit ka vendosur që ankesa e ankueses është e pabazuar, ndërsa për ankuesen me nr. C-0035 Belkize Vula Shala, Kolegji i Apelit ka vendosur që ankesa e ankueses është e paafatshme. Në bazë të asaj që është paraqitur në kërkesë dhe në Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit, ne kemi ardhur në përfundim se kërkesa në gjykatë është parashtruar nga ana e parashtrueses Belkize Vula Shala nr. C-0024-02.

sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2003/13 përkatësisht neni 10 pika 4 të së njëjtës për tu njohur e drejta e futjes në listën përfundimtare të NSH "Agimi" për përfitimin e 20% nga shitja e ndërmarrjes".

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

33. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që përmes Aktgjykimit [AC-I-13-0181-A0008] të 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) e nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.

34. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës fillimisht theksojnë se të gjithë kanë qenë punëtorë të NSH "Agimi", dhe se kjo vërtetohet edhe përmes shkresës së AKP-së e cila u është drejtuar më 15 shtator 2010, përmes së cilës janë njoftuar se si rezultat i privatizimit të ndërmarrjes në fjalë, janë ndërprerë të gjitha marrëdhëniet përkatëse të punës, dhe se rrjedhimisht të njëjtit, i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores 2003/03 për të përfituar nga njëzet përqindëshi (20%-it) i privatizimit të ndërmarrjes përkatëse. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ata kanë dorëzuar provat në dispozicion, por që "*prova përkatëse kanë qenë në disponim të Zyrës kadrovike të Sh.A. "Agimi" në Gjakovë e më pastaj të stafit të emëruar nga AKP-ja, punëtor të ish-Sh.A. ose N.SH "Agimi" Gjakovë*".

35. Të njëjtit, në esencë, pretendojnë se Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të garantuara përmes neneve të lartcekura sepse i njëjti (i) ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe i cili ka qenë në favor të parashtrueseve të kërkesës, pa një seancë dëgjimore, duke mos u mundësuar të njëjtëve për tu deklaruar rreth fakteve kontestuese, duke theksuar se "*është e vërtetë që Dhoma e Posaçme ka mundësi të mban gjykim edhe pa prezencën e palëve, por është gjithashtu e vërtetë se ka të drejtë që të caktoj seancë publike dhe në atë do të i epej mundësia Gjykatës dhe palëve të ballafaqojnë parashtrimet dhe provat, do të bëhej një gjykim i hapur, i drejtë dhe transparent që do të argumentoheshin faktet relevante*"; (ii) për dallim prej Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, ngërthen interpretim arbitrar përkitazi me diskriminimin sepse barra e të provuarit lidhur me pretendimet për diskriminim bazuar në nenit 8 të Ligjit kundër Diskriminimit i takon

AKP-së; (iii) nuk është i arsyetuar; dhe (iv) ka shkelur të drejtat e tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

36. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ata nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë me punëtorët e tjerë të NSH "Agimi", "*situata juridike dhe faktike*" e të cilëve është identike me parashtruesit e kërkesës, ndërsa Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, i ka trajtuar pretendimet e tyre në kuptim të diskriminimit etnik, duke u referuar në të "*drejtën precedentale*".

37. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata: (i) t'i deklarojë kërkesat të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; (iii) ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, dhe të njëjtin ta kthejë për rigjykim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesat i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

40. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale) dhe 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të
ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ... ".

41. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesave janë palë të autorizuara, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe i kanë dorëzuar kërkesat në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

42. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

3. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
4. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

LIGJI Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 10
Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet

[...]

11. Në rastet kur kolegji i apelit pranon dhe merr përsipër vendosjen mbi një apel, rregullat në vijim respektohen fuqimisht: 11.1. kolegji i apelit nuk mund të ndryshojë, anulojë, rikthejë apo përndryshe të ndërrojë, në çfarëdo mënyrë, gjetjet faktike të bëra nga një gjykatë, kolegj i specializuar, nën-kolegj apo gjyqtar i vetëm, përveç nëse kolegji i apelit përcakton që ajo gjetje faktike është qartësisht e gabueshme. Gjetja faktike nuk vlerësohet të jetë qartësisht e gabueshme nëse ajo gjetje faktike mbështetet me interpretim të arsyeshëm të dosjes së procedurave gjyqësore dhe provave të parashtruara gjatë atyre procedurave; si dhe 11.2. kolegji i apelit bën shqyrtim, prej fillimit, të secilës çështje që ngrihet nga apeluesi apo pala kundërshtare në parashtresat e tij/saj me shkrim.
[...]

Shtojca e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Rregullorja e Punës e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 36
Rregullat e përgjithshme mbi provat

[...]
3. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dështmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Neni 68
Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime

1. Përveç nëse nuk përcaktohet saktësisht me këtë nen, procedura për lëndët që bazohen në ankesat që bien nën paragrafin 1.6. të nenit 4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme do të ndjek rregullat e tjera procedurale të përshkruara në këtë Shtojcë e që Dhoma e Posaçme i zbaton mutatis mutandis nëse i vlerëson si të domosdoshme dhe në interes të drejtësisë.
2. Pas pranimit të listës së të punësuarve me të drejta legjitime në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo në bazë të çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një

liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas datës së shpalljes, duke kërkuar përfshirjen në një listë të tillë dhe/apo duke sfiduar përfshirjen e një apo më shumë personave tjerë në një listë të tillë. Personi i cili parashtron një kërkesë apo kundërshtim të tillë, do të përfshijë aty në deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështesin kërkesën apo kundërshtimin e tillë; ai person ka barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në kërkesë dhe/apo në kundërshtim.
[...]
6. Agjencia shpallë listën e saj përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime në mbështetje të paragrafit 5. të këtij neni e në përputhje me nenin 10.6. të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, ose në pajtim me çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas ditës së shpalljes për të kundërshtuar në listë të tillë dhe/apo në lidhje me shpërndarjen e fondeve të mbledhura nga Agjencia për personat e identifikuar në atë listë. Ankuesi(t) që parashtrojnë një ankesë të tillë përfshijnë një deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështetin ankesën e tillë; personat që ankohen kanë barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në ankesë.
[...]
11. Kolegji gjegjës i Specializuar, me nismë të vet apo në bazë të një kërkese me shkrim nga ankuesi(t) apo Agjencia, mund të vendos për mbajtjen e një apo më shumë seancave gojore lidhur me çështjen. Nëse mbahet një seance gojore, atëherë Kolegji Specializuar do të udhëzojë Regjistër mbajtësin që, së paku pesë (5) ditë më herët para seancës gojore, t"i dorëzojë palëve një njoftim me shkrim për kohën dhe ditën e seancës së tillë.
[...]
14. Kolegji i Apelit zgjidhë të gjitha apelet e tilla urgjentisht.

Neni 64
Procedurat e ankesës me gojë

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkese për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë

parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.
[...]

Neni 65
Paraqitja e provave të reja

Në rrethana të jashtëzakonshme dhe për arsye që dëshmohen mirë, Kolegji i Apelit mund t"i lejoj një pale paraqitjen e provave të reja që nuk kanë qenë në dispozicion të palës gjatë procedurës së shkallës së parë për vlerësimin e provave. Kërkesa me shkrim për një leje të tillë duhet së pari t"i dorëzohet Kolegjit të Apelit dhe duhet t"i dorëzohet palëve tjera jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së seancës kur propozohet paraqitja e këtyre provave. Kolegji i Apelit mund të autorizojë paraqitjen e provave të reja nëse vlerëson se në këtë mënyrë drejtësia do të vihet në vend.

Rregullore Nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në Pronësi Shoqërore

Neni 10
Të Drejtat E të punësuarve

[...]
10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilit pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qënë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.
[...]

Rregullore Nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores Nr. 2003/ 13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore

Neni 1
Ndryshimet

Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje,
[...]

B. Nenet 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 ndryshohen si vijon:
[...]
10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit apo të fillimit të procedurës së likuidimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vite. Kjo kërkesë nuk i përjashton punëtorët nga paraqitja e ankesës në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6., të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar po të mos kishin qenë të diskriminuar.
[...]

Ligji Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 69
Procedurat e ankesës me gojë

2. *Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkese për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.*
[...]

Ligji Nr. 2004/3 kundër Diskriminimit

Neni 8
Barra e provave

8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.
8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda te tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore.

Meritat e kërkesës

43. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me privatizimin e ndërmarrjes shoqërore NSH "Agimi" në Gjakovë, dhe të drejtat e punëtorëve përkatës për t'iu njohur statusi i punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga ky privatizim, siç është përcaktuar në nenin 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, dhe paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores 2003/13 e ndryshuar me Rregulloren nr. 2004/45.

44. Gjykata vëren se bazuar në shkresat e lëndës, NSH "Agimi" ishte privatizuar më 15 shtator 2010, datë kjo në të cilën gjithashtu parashtruesit e kërkesës përmes shkresave individuale ishin njoftuar se "*pasoja shitjes së aseteve kryesore është përfundimi i punësimit tuaj*" dhe se i njëjti "*përfundon menjëherë*". Parashtruesit e kërkesës më pas kishin kontestuar mospërfshirjen e tyre në Listën e Përkohshme të AKP-së për punëtorët me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi". Këto ankesa ishin refuzuar.

45. Parashtruesit e kërkesës fillimisht kishin iniciuar padi në Kolegjin e Specializuar, duke kontestuar Vendimin e AKP-së, përkitazi me vërtetimin e fakteve edhe interpretimin e ligjit. Të njëjtit kishin pretenduar se ishin diskriminuar dhe të gjithë kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore para Kolegjit të Specializuar.

46. Kolegji i Specializuar, kishte refuzuar kërkesën për seancë dëgjimore me arsyetimin se *"faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaft të qarta"*. Kolegji i Specializuar u kishte dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës, me përjashtim të parashtruesit të kërkesës Agim Buza (KI187/19), duke konstatuar se të njëjtit ishin diskriminuar. Kolegji i Specializuar, kishte theksuar se "*anëkuesit do i kishin plotësuar kushtet në kuptim të nenit 10.4 të Rregullores 2003/13, po mos të ishin subjekt të diskriminimit, ngase të njëjtëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës gjatë viteve 1990 dhe janë larguar nga puna duke u zëvendësuar me punëtor serb*".

47. Pas nxjerrjes së këtij Aktgjykimi, fillimisht ankesë në Kolegj të Apelit kishin paraqitur (i) Agim Buza (KI187/19), të vetmit parashtrues ankesën e të cilit Kolegji i Specializuar e kishte refuzuar si të pabazuar, duke paraqitur para Kolegjit të Apelit dokumente shtesë; dhe (ii) AKP-ja. As të parët as i dyti, nuk kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore.

48. Gjykata vëren se në gusht të vitit 2019, Kolegji i Apelit, kishte nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar, përmes së cilit kishte miratuar ankesën e AKP-së dhe kishte refuzuar ankesën e Agim Buzës, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe për pasojë, duke hequr "*nga lista e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të NSH-së "Agimi" Gjakovë",* të gjithë parashtruesit e kërkesës.

49. Kolegji i Apelit, shprehimisht kishte vendosur të *"heq dorë nga pjesa e seancës gojore",* duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 (Procedura e ankesës me gojë) të Ligjit nr. 06/L-086 për DHPGJS-në. Ndërsa, përkitazi me meritat e çështjes, (i) kishte konstatuar se provat e paraqitura nga palët përkatëse nuk dëshmojnë se të njëjtit i plotësojnë kushtet ligjore të përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13 për t'iu njohur të drejtat përkatëse; dhe (ii) kishte theksuar se interpretimi i diskriminimit nga Kolegji i Specializuar është në kundërshtim me "*të drejtën precedentale*" të DHPGJS-së.

50. Rrejdhimisht para Gjykatës këto konstatime të Kolegjit të Apelit, parashtruesit e kërkesës i kontestojnë, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Përkitazi me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës, siç është sqaruar më lart, pretendojnë se Kolegji i Apelit ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, (i) pa një seancë dëgjimore; (ii) pa arsyetim të mjaftueshëm; (iii) në interpretim arbitrar të ligjit; dhe (iv) në shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

51. Pretendimet e parashtruesve, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

52. Gjykata, në këtë aspekt, fillimisht do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesëve të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seancë dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit.

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore në kuptim të nenit 6 të KEDNJ

53. Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së, në parim, garanton mbajtjen e një seance dëgjimore në të paktën njërin nivel të vendimmarrjes. Një e tillë është, në parim, (i) e detyrueshme nëse gjykata e shkallës së parë ka kompetencën e vetme të vendimmarrjes përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit; (ii) jo e detyrueshme në shkallë në dytë nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallë të parë, përkundër faktit që një përcaktim i tillë varet nga karakteristikat e rastit përkatës, për shembull, nëse shkalla e dytë vendos edhe për çështje fakti edhe ligji; dhe (iii) e detyrueshme në shkallë të dytë nëse një e tillë nuk është mbajtur në shkallë të parë, në rastet kur shkalla e dytë ka kompetencë të plotë për të vlerësuar vendimin e shkallës së parë, edhe përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Fredin kundër Suedisë (nr. 2)*, Aktgjykim i 23 shkurtit 1994, paragrafët 21-22; *Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2)*, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 46). Përjashtime nga këto raste, në parim, bëhen vetëm nëse *"ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore"*, dhe të cilat GJEDNJ, përmes praktikës së saj gjyqësore i ka përcaktuar si raste që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës së lartë teknike (shih rastin e GJEDNJ-së, *Koottummel kundër Austrisë*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009, paragrafët 19 dhe 20).

54. Për sa i përket detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë, GJEDNJ ka theksuar se në procedurat para një gjykate të shkallës së parë dhe të vetme, e drejta për një seancë dëgjimore është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Fredin kundër Suedisë (nr. 2)*, Aktgjykim i 23 shkurtit 1994, paragrafët 21-22; *Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2)*, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 46; *Göç kundër Turqisë*, Aktgjykim i 11 korrikut 2002, paragrafi 47).

55. Për sa i përket detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Salomonsson kundër Suedisë*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 36). Prandaj, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore.

56. Për sa i përket parimeve në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme, Gjykata i referohet Aktgjykimit të 6 nëntorit 2018 të GJEDNJ-së: *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, në të cilin Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së, vendosi parimet bazuar në të cilat duhet të vlerësohet domosdoshmëria e një seance dëgjimore. Sipas këtij Aktgjykimi, një seancë dëgjimore nuk është e domosdoshme nëse rasti përkatës (i) ngërthen thjeshtë çështje juridike të një natyre të kufizuar (shih rastet e GJEDNJ-së, *Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2)*, cituar më lartë, paragafi 49; dhe *Valová, Slezák dhe Slezák kundës Sllovakisë*, Aktgjykim i qershorit 2004, paragrafët 65-68) ose nuk ngërthen ndonjë ndërlikueshmëri të veçantë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Varela Assalino kundër Portugalisë,* Vendim i 25 prillit 2002); dhe (ii) ngërthen çështje tepër teknike, të cilat trajtohen më mirë me shkrim sesa përmes argumenteve gojore në një seancë dëgjimore; dhe (iii) nuk ngërthen çështje të besueshmërisë së palëve ose fakteve të kontestuara dhe gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme në bazë të parashtresave të palëve dhe materialeve të tjera me shkrim (shih rastet e GJEDNJ-së, *Döry kundër Suedisë*, Aktgjykim i 12 nëntorit2002, paragrafi 37; dhe *Saccoccia kundër Austrisë*, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008, paragrafi 73).

57. Për sa i përket mundësisë së korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë dhe kritereve respektive, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar se në parim, një korrigjim i tillë varet nga kompetencat e gjykatës më të lartë. Nëse kjo e fundit, ka juridiksion të plotë për të shqyrtuar meritat e rastit përkatës, përfshirë edhe vlerësimin e fakteve, atëherë korrigjimi i mungesës së një seance dëgjimore në shkallë të parë, mund të bëhet në shkallën e dytë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 192 dhe referencat e përdoruar aty).

58. Përfundimisht, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, fakti që palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore nuk do të thotë që të njëjtat kanë hequr dorë nga e drejta për të mbajtur një të tillë. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, një çështje e tillë varet nga karakteristikat e ligjit vendor dhe rrethanat e secilit rast veç e veç (shih rastin e GJEDNJ-së, *Göç kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 48).

(v) Aplikimi i parimeve të shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret

59. Gjykata në këtë aspekt, fillimisht rikujton që përmes ankesave individuale të parashtruara në Kolegjin e Specializuar si shkallë e parë, të gjithë parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. Kolegji i Specializuar kishte refuzuar mbajtjen e të njëjtës, duke theksuar se bazuar në paragrafin 11 të nenit 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-së, seanca dëgjimore nuk ishte e nevojshme sepse "*faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaftë të qarta*". Siç, është sqaruar tashmë, Kolegji i Specializuar, bazuar në këto *"fakte dhe prova"*, kishte vendosur se parashtruesit e kërkesës, me përjashtim të parashtruesit Agim Buza, ishin diskriminuar duke vendosur gjithashtu se të njëjtit duhet të përfshihen ne Listën Përfundimtare të AKP-së si punëtorë me të drejta legjitime për të përfituar nga njëzet përqindëshi (20%-it) i privatizimit të ndërmarrjes NSH "Agimi".

60. Në Kolegjin e Apelit ishin ankuar vetëm AKP dhe Agim Buza sepse të njëjtëve iu ishte refuzuar ankesa përmes Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar. Kolegji i Apelit kishte vendosur në favor të AKP-së, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe duke refuzuar ankesat e të gjithë parashtruesve përkitazi me mospërfshirjen në Listën Përfundimtare të AKP-së si rezultat i diskriminimit. Siç është sqaruar më lart, Kolegji i Apelit kishte vendosur të *"heq dorë nga pjesa e seancës gojore",* duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 69 të Ligjit nr. 06/L-086për DHPGJS-në. Parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Agim Buza, i vetmi parashtrues që ishte ankuar në Kolegjin e Apelit për shkak të Aktgjykimit refuzues në shkallë të parë, nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. Po ashtu edhe pjesa e parashtruesve të tjerë të kërkesës, në këtë rast Belkize Vula Shala dhe Shkëndije Shehu, të cilat kishin paraqitur dokumente shtesë në përgjigje të ankesës së AKP-së ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, por nuk kishin kërkuar mbajtjen e një seancë dëgjimore.

61. Megjithatë, siç është sqaruar më lart, fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë bërë kërkesë për një seancë dëgjimore para Kolegjit te Apelit, jodetyrimisht do të thotë se të njëjtit kanë hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga një kërkesës e tillë, dhe gjithashtu mungesa e kësaj kërkese jodetyrimisht e liron gjykatën përkatëse nga detyrimi për mbajtjen e një seancë të tillë.

62. Më saktësisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në rrethanat e rasteve në të cilat palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seancë dëgjimore, GJEDNJ, ndër tjerash vlerëson nëse mungesa e një kërkesë të tillë, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar të një parashtruesi nga e drejta për një seancë dëgjimore. Thënë këtë, mungesa e kërkesës për një seancë dëgjimore, bazuar në praktikën

gjyqësore të GJEDNJ-së, asnjëherë nuk është faktori i vetëm që determinon domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance dëgjimore. Në të gjitha rastet, nëse mungesa e kërkesës për seancë dëgjimore e liron një gjykatë nga detyrimi për mbajtjen e një seancë dëgjimore, varet nga (i) specifikat e ligjit të aplikueshëm; dhe (ii) rrethanat e një rasti konkret.

63. Së pari, përkitazi me (i) specifikat e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht Ligjit dhe Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Gjykata rikujton se bazuar në nenin 64 (Procedurat e ankesës me gojë) të të njëjtit ligj, "*Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse*", në bazë të nismës së tij apo edhe kërkesës me shkrim nga një palë. Neni 69 (Procedurat e ankesës me gojë) i Ligjit Nr. 06/L-086 për DHPGJS, ka të njëjtën përmbajtje. Bazuar në këto dispozita rrjedhimisht, mbajtja e një seancë dëgjimore në nivel apeli, jodetyrimisht varet nga kërkesa e palës. Është gjithashtu detyrë e Kolegjit përkatës, që bazuar në nismën e tij, të vlerësojë nëse rrethanat e një rasti kërkojnë mbajtjen e një seance dëgjimore. Për më tepër, bazuar në nenin 60 (Përmbajtja e ankesës) dhe nenin 65 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të vlerësojë edhe çështjet e ligjit edhe të faktit, dhe për pasojë, është e pajisur me kompetencë të plotë për të vlerësuar mënyrën se si ka vlerësuar faktet autoriteti më i ulët, përkatësisht Kolegji i Specializuar (shih rastet e Gjykates Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19 Parashtrues Et-hem Bokshi dhe te tjeret, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 61).

64. Në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Apelit ka vlerësuar faktet dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe ka ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar edhe përkitazi me vlerësimin e fakteve edhe interpretimin e ligjit, në dëm të parashtruesve të kërkesës**.** Në rrethana të tilla, duke marrë parasysh dispozitat ligjore, Gjykata nuk mund të konstatojë se mungesa e një seance dëgjimore në Kolegj të Apelit është e justifikuar vetëm si rezultat i mungesës së një kërkese nga palët në procedurë. Siç është sqaruar më lartë, bazuar në nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në është detyrim i Kolegjit të Apelit që edhe me nismën e tij të vlerësojë nëse mbajtja e një seancë dëgjimore është e detyrueshme, dhe nëse jo, të arsyetoj mos-mbajtjen e së njëjtës.

65. Së dyti, përkitazi me (ii) rrethanat e një rasti konkret, Gjykata rikujton që praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, thekson se mungesa e një kërkese për një seancë dëgjimore, dhe vlerësimi nëse ky fakt mund të rezultojë

në konstatimin se pala përkatëse në mënyrë të nënkuptuar ka hequr dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore, duhet të vlerësohet në tërësinë e specifikave të një procedure, dhe jo si argument i vetëm, për të konstatuar nëse mungesa e një seance dëgjimore ka rezultuar ose jo në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastet: KIKl145/19, Kl146/19, Kl147/19, Kl149/19, Kl150/19, Kl151/19, Kl152/19, Kl153/19, Kl154/19, Kl155/19, Kl156/19, Kl157/19 dhe Kl159/19, cituar më lartë, paragrafi 62).

66. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, (i) parashtruesve të kërkesës nuk iu është dhënë mundësi të dëgjohen para Kolegjit të Specializuar, me kompetencë për vlerësimin e fakteve dhe të ligjit, përkundër kërkesës së tyre; (ii) si dhe parashtruesit e kërkesës nuk ishin ankuar (përveç parashtursit Agim Buza) në Kolegjin e Apelit sepse vendimi i Kolegjit të Specializuar ishte në favor të tyre; (iii) procedura në Kolegjin i Apelit ishte iniciuar përmes ankesës së AKP-së; (iv) Kolegji i Apelit, kishte *"hequr dorë nga seanca"*, duke u referuar në nenin 69 të Ligjit 06/L-086 për DHPGJS-në, nen ky identik me nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, të cilët thjeshtë përcaktojnë se "*Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse*"; dhe (v) Kolegji i Apelit, ne baze te ankesës se AKP dhe parashtruesit Agim Buza kishte shqyrtuar të gjitha faktet e rastit, duke përshirë ankesat e parashtruesve të dorëzuara në shkallë të parë, dhe duke theksuar se nuk pajtohet as me vlerësimin e fakteve dhe as me interpretimin e ligjit nga gjykata e shkallës më të ulët, kishte ndryshuar në tërësi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, duke i hequr të gjithë parashtruesit e kërkesës nga Lista e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar nga njëzet përqindëshi (20%-it) i privatizimit të ndërmarrjes NSH "Agimi".

67. Në rrethana të tilla, Gjykata nuk mund të konstatojë se mungesa e kërkesës së parashtruesve të kërkesës për mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar e tyre nga e drejta për një seancë dëgjimore. Gjykata rikujton se në të gjitha rastet në të cilat GJEDNJ kishte arritur në një konstatim i tillë, e kishte bërë në ndërlidhje me faktin se rrethanat e rasteve ndërlidheshin me çështje të natyrës ekskluzivisht ligjore ose të natyrës teknike, dhe rrjedhimisht "*ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seancë dëgjimore*". Për pasojë dhe në vijim, Gjykata duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, "*ekzistojnë rrethanat të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*", përkatësisht nëse natyra e çështjeve në vlerësim para

Kolegjit të Apelit, mund të klasifikohet si "*ekskluzivisht ligjore apo e natyrës së lartë teknike*" (shih rastet e Gjykates Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI15l/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, K1157/19 dhe K1159/19 Parashtrues Et-hem Bokshi dhe te tjeret, cituar me lart, paragrafi 68).

68. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që Kolegji i Apelit, ka juridiksion edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji. Bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 (Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet) të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Ligji për DHPGJS-në) dhe paragrafin 4 të nenit 64 (Procedurat e ankesës me gojë) dhe nenin 65 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, palët, ndër tjerash, kanë mundësinë që të ngritin ankesat para Kolegjit të Apelit edhe përkitazi me çështjet e ligjit edhe të fakteve, duke përfshirë edhe mundësinë që të paraqiten prova të reja.

69. Për më tepër, në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar të gjitha faktet e paraqitura përmes (i) ankesës fillestare të parashtruesve të kërkesës në Kolegjin e Specializuar dhe përgjigjet në ankesë të AKP-së; dhe (ii) ankesës së AKP-së dhe të Agim Buzës në Kolegjin e Apelit dhe të përgjigjeve përkatëse në ankesë të parashtruesve të kërkesës. Përkundër faktit që Kolegji i Specializuar kishte vlerësuar se provat *"janë të qarta"* duke u dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës, Kolegji i Apelit bazuar po në të njëjtat fakte/prova kishte konstatuar të kundërtën.

70. Gjykata gjithashtu rikujton që bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 të Ligjit nr. për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit është i kufizuar në ndërrimin e vlerësimit të gjendjes faktike të bërë nga Kolegji i Specializuar, përpos nëse përcakton që gjetjet faktike të gjykatës më të ultë janë "*qartësisht të gabueshme*", rregull kjo që sipas të njëjtit nen duhet të "*respektohet fuqimisht*". Një arsyetim i tillë, nuk gjendet në Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit. Ky i fundit, thjesht nuk ishte pajtuar më vlerësimin e provave nga Kolegji i Specializuar, dhe gjithashtu kishte konstatuar se interpretimi të cilin Kolegji i Specializuar ia ka bërë pretendimeve përkitazi me diskriminim, është në kundërshtim me *"të drejtën precedentale"*.

71. Gjykata më tej vëren, se bazuar në nenin 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, në rast të ankesave lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, barra e provës bie mbi

parashtruesit e kërkesës përkatëse para Kolegjit të Specializuar. Po ashtu, barra e të provuarit për kundërshtuesin e një kërkesë të tillë, bie mbi kundërshtuesin, përkatësisht AKP-në, në rrethanat e rastit konkret. Para Kolegjit të Apelit, barra e të provuarit gjithashtu bie mbi parashtruesin e ankesës përkatëse. Por, rrethanat e rastit konkret, gjithashtu, në esencë ndërlidhen me pretendime për diskriminimin. Në rast të pretendimeve të tilla, barra e të provuarit, bazuar në nenin 8 (Barra e provave) të Ligjit kundër Diskriminimit, bie mbi palën e paditur, përkatësisht AKP-në, dhe jo parashtruesit e kërkesës (shih rastet e Gjykates Kushtetuese nr. Kl145/19, Kl146/19, Kl147/19, Kl149/19, Kl150/19, KI151/19, KI152/19, Kl153/ 19, Kl154/19, KI155/19, Kl156/19, KI157/19 dhe Kl159/19, parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët, cituar më lart, paragrafi 76).

72. Në rrethanat e tilla, në të cilat (i) Kolegji i Apelit ka shqyrtuar edhe çështje fakti edhe ligji; (ii) në të cilat përkitazi me faktet, barra e të provuarit se i plotësojnë kriteret e paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13, në parim bie mbi parashtruesit e kërkesës, ndërsa barra e të provuarit lidhur me diskriminimin bie mbi AKP-në; dhe (iii) Kolegji i Apelit interpreton të njëjtat fakte të paraqitura nga palët në mënyrë të ndryshme nga mënyra se si i ka interpretuar Kolegji i Specializuar, duke ndryshuar Aktgjykimin në dëm të palëve, përkundër faktit që një mundësi e tillë bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-033 për DHPGJS-në, i është njohur vetëm përjashtimit, me kushtin që të argumentojë që autoriteti më i ulët, përkatësisht Kolegji i Specializuar, ka bërë interpretim *"qartësisht të gabueshëm"*, Gjykata vlerëson se është e pakontestueshme që çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk është (i) as çështje ekskluzivisht ligjore; dhe (ii) as e natyrës teknike. Përkundrazi, çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit ngërthente çështje të rëndësishme faktike dhe ligjore. Në një situatë të tillë, rëndësia për palët që t'iu ofrohet një seancë kontradiktore përpara organit që kryen rishikimin gjyqësor nuk duhet të nënvlerësohet. Për pasojë, Gjykata duhet të konstatojë, se në rrethanat e rastit konkret, nuk ekzistojnë rrethana të cilat do e justifikonin mungesën e seancës dëgjimore (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. Kl145/19, Kl146/19, Kl147/19, Kl149/19, Kl150/19, KI151/19, KI152/19, Kl153/ 19, Kl154/19, KI155/19, Kl156/19, KI157/19 dhe Kl159/19, parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët, cituar më lart, paragrafi 77).

73. Në mbështetje të këtij konstatimi, Gjykata rikujton që përmes Aktgjykimit të GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër*

Portugalisë, specifikisht ishte përcaktuar se një seancë dëgjimore është e domosdoshme në rrethana që ngërthejnë nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë. Kjo vlen posaçërisht në rrethana në të cilat, një seancë dëgjimore nuk është mbajtur as para shkallës më të ulët, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret.

74. Në fund, Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se Kolegji i Apelit nuk kishte arsyetuar *"heqjen dorë nga seanca"*, por ishte mjaftuar vetëm me referim në nenin 69 të Ligjit 06/L-086 për DHPGJS-në. Ky i fundit, siç është sqaruar më lart, thjesht përcakton kompetencën e Kolegjit të Apelit për të vendosur për mbajtjen e seancës dëgjimore bazuar në nismën e tij ose me kërkesë të palës. Aktgjykimi përkatës nuk përmban asnjë sqarim shtesë lidhur me vendimin e Kolegjit të Apelit për të *"hequr dorë nga seanca"*. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me mungesën e një seance dëgjimore, duhet të shqyrtohet edhe nëse refuzimi i mbajtjes së një seance të tillë është i arsyetuar (shih rastin e GJEDNJ-së *Pönkä kundër Estonisë*, Aktgjykimi i 8 nëntorit 2016, paragrafët 37-40; dhe *Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë*, paragrafi 44). Në kontekst të mungesës së arsyetimit të mosmbajtjes së një seance dëgjimore, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, në mënyrë të vazhdueshme, ndër të tjera, ka theksuar se nga mungesa e arsyetimit rreth nevojës për mbajtjen e një seance dëgjimore, i pamundëson gjykatës më të lartë, të vlerësojë nëse një mundësi e tillë thjeshtë është neglizhuar, apo cilat janë argumentet bazuar në të cilat gjykata ka anashkaluar një mundësi të tillë në raport me rrethanat që ngre një rast i caktuar (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI145/19, KI146/19, KI47/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët, cituar më lart, paragrafi 80; dhe rastin e GJENDJ-së *Mirovni Institut kunder Sllovenise*, paragrafi 44 dhe referencat e perdoruara aty).

75. Prandaj, dhe në përfundim, Gjykata, duke marrë parasysh që (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar shprehimisht mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton se të njëjtit kanë hequr dorë nga kjo e drejtë, posaçërisht duke marrë parasysh që të njëjtit nuk kanë iniciuar ankesën para Kolegjit të Apelit dhe gjithashtu mungesa e kësaj kërkesë, nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi për vlerësimin e domosdoshmërisë së një seance dëgjimore; (ii) përkundër kërkesës specifike të parashtruesve përkatës

për seancë dëgjimore para Kolegjit të Specializuar, një e tillë nuk ishte mbajtur dhe rrjedhimisht, standardet që aplikohen për domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit janë më rigoroze, sepse, në parim, palët kanë të drejtë në një seancë dëgjimore të paktën para një instance gjyqësore; (iii) çështjet në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk mund të kualifikohen as si çështje ekskluzivisht ligjore dhe as çështje të natyrës teknike, por përkundrazi si çështje të faktit dhe ligjit; (iv) Kolegji i Apelit kishte vlerësuar mënyrën se si instanca më e ultë, përkatësisht Kolegji i Specializuar kishte bërë vlerësimin e fakteve, duke e ndryshuar Aktgjykimin e tij në dëm të parashtruesve të kërkesës; dhe (v) Kolegji i Apelit nuk e kishte arsyetuar "*heqjen dorë nga seanca*"; konstaton se në rastin konkret nuk kanë "*ekzistuar rrethana të jashtëzakonshme për të justifikuar mungesën e një seance dëgjimore*", dhe për pasojë, Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

76. Gjykata në fund gjithashtu thekson, se duke marrë parasysh që tashmë ka konstatuar që Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së rrethanave të jashtëzakonshme të cilat do të mund të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore, konsideron se nuk do të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të tjera të parashtruesve të kërkesës. Pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Për më tepër, duke marrë parasysh që Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për të shqyrtuar vendimet e kontestuara të Kolegjit të Specializuar bazuar në ligjet e aplikueshme për DHPGJS-në, i njëjti ka mundësinë e korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë.

77. Konstatimi i Gjykatës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet ekskluzivisht me mungesën e seancës dëgjimore, siç është sqaruar në këtë Aktgjykim, dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me dhe as nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

Përfundimi

78. Gjykata ka vlerësuar pretendimet e parashtruesve te kërkesës, përkitazi me mungesën e seancës dëgjimore në rrethanat e rastit të tyre, si një ndër garancitë e përcaktuara përmes nenit 31 të

Kushtetutës në lidhje me nenit 6 të KEDNJ-së, duke aplikuar mbi këtë vlerësim në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

79. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tyre nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtojë me nismën e tij domosdoshmërinë e mbajtjes së një seancë dëgjimore; (ii) parashtruesve të kërkesës iu është mohuar e drejta e seancës dëgjimore në të dy nivelet e DHPGJS-së; (iii) Kolegji i Apelit, nuk kishte trajtuar "*çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike*" dhe rrjedhimisht nuk "*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*"; (iv) Kolegji i Apelit kishte shqyrtuar çështje "*fakti dhe ligji*" për më tepër që, kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar në dëm të parashtruesve të kërkesës; dhe (v) Kolegji i Apelit, nuk kishte arsyetuar "*heqjen dorë nga seanca gojore*". Duke marrë parasysh këto rrethana dhe arsyetimet e tjera të dhëna në këtë Aktgjykim, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore.

80. Përfundimisht, Gjykata gjithashtu theksoi se (i) bazuar në ligjin e aplikueshëm për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për vlerësimin e vendimeve të Kolegjit të Specializuar dhe rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka mundësinë e korrigjimit të mungesës së seancës dëgjimore në nivelin e gjykatës më të ulët, përkatësisht, Kolegjit të Specializuar; dhe (ii) nuk është e nevojshme të trajtohen pretendimet e tjera të parashtruesve të kërkesës sepse të njëjtat duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit në përputhshmëri me konstatimet e këtij Aktgjykimi; dhe (iii) konstatimi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret ndërlidhet vetëm me garancitë procedurale për një seancë dëgjimore dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet, si dhe nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 prill 2021, me shumicë votash:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-13-0181-A0008] e 29 gushtit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme;

IV. TË KTHEJË çështjen në rigjykim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi;

V. TË URDHËROJË Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës deri më 28 korrik 2021;

VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

KI 11/21 Parashtrues, Sami Nuhaj, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 325/2020 të 16 dhjetorit 2020

KI 11/21, Aktvendim për papranueshmëri i 25 marsit 2021, publikuar më 1 qershor 2021

Fjalët kyç: person fizik, rast penal, kërkesë për masë të përkohshme, kërkesë për mbajtjen e seancës dëgjimore publike, aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës kishte themeluar një kompani ndërtimore dhe se gjatë kryerjes së punimeve në vend punishte, një nga punëtorët pësoi një aksident, si rezultat i të cilit ai vdiq.

Prokuroria ngriti aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës, si person përgjegjës, për veprën penale "*në bashkëkryerje asgjësim, dëmtim ose heqjen e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikim i sigurisë në vendin e punës nga neni 367 par. 2 lidhur me par. 7 dhe 3 dhe nenit 31 të* Kodit Penal të Kosovës".

Gjykata Themelore e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor, duke e dënuar atë me burgim. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme vërtetuan aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

Parashtruesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar, ndër të tjera, shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], të Kushtetutës, si dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke deklaruar se gjykatat nuk i arsyetuan vendimet e tyre dhe se në rastin e tij ishte zbatuar analogjia.

Pasi analizoi shkresat e lëndës si dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstatoi se gjykatat e rregullta kishin respektuar parimet e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me vendimet e arsyetuara, dhe se nuk ka pasur zbatim të analogjisë në rastin e tij.

Prandaj, Gjykata e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI11/21

Parashtrues

Nuhaj Sami

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 325/2020 të 16 dhjetorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Nuhaj Sami nga Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesin e kërkesës e përfaqëson Artan Qerkini, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 325/2020 të 16 dhjetorit 2020, përmes të cilit është refuzuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PA1. nr. 129/2020 të 14 korrikut 2020 dhe Aktgjykimit P. nr. 298/2019 të Gjykatës Themelore në Ferizaj të 30 dhjetorit 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], të Kushtetutës së Republikës të Kosovës, si dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 7 (Nuk

ka dënim pa ligj) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës kërkon që të mbahet një seancë dëgjimore publike.

5. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon vendosjen e masës së përkohshme, me të cilën do të pezullohej ekzekutimi i aktgjykimit përfundimtar të Gjykatës Supreme PML. nr. 325/2020 të 16 dhjetorit 2020.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] 39 dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 14 janar 2021, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 18 janar 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

9. Më 3 shkurt 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Më 25 mars 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës është pronar i ndërmarrjes ndërtimore PGP "Vizioni – S" SHPK në Ferizaj, e cila merret me kryerjen e punëve ndërtimore.

12. Më 29 nëntor 2014, rreth orës 15:00, ndodhi një aksident në punishte, në objektin ku kryhen punimet e ndërtimit nga kompania e parashtruesit të kërkesës, ku personi M.A. kishte rënë nga kati i 8 i objektit, duke pësuar lëndime nga të cilat ai kishte vdekur.

13. Më 3 dhjetor 2015, Prokuroria Themelore në Ferizaj ngriti aktakuzën PP. nr. 2986/2014, në Gjykatën Themelore, kundër parashtruesit të kërkesës dhe personit L.N., për shkak të veprës penale "*në bashkëkryerje asgjësim, dëmtim ose heqjen e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikim i sigurisë në vendin e punës nga neni 367 par. 2 lidhur me par. 7 dhe 3 dhe nenit 31 të* Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK), si dhe kundër personit juridik PGP „Vizioni – S" SHPK, me personin përgjegjës Sami Nuhaj, për shkak të veprës penale "*asgjësim, dëmtim ose heqje c pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikim i sigurisë në vendin e punës nga neni 367 par. 2 lidhur me par. 7 dhe 3 dhe në lidhje me nenin 40 të KPRK-së".*

14. Më 18 maj 2018, Gjykata Themelore në Ferizaj nxori Aktgjykimin P. nr. 1525/2015, me të cilin e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale *"asgjësim, dëmtim ose heqje c pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikim i sigurisë në vendin e punës nga neni 367 par. 2 lidhur me par. 7 dhe 3 të KPRK-së,* dhe e dënoi atë me burgim për një afat prej 1 (një) viti dhe 3 (tre) muaj, ndërsa refuzoi aktakuzën e Prokurorisë Themelore kundër personit L.N.

15. Me të njëjtin aktgjykim, Gjykata Themelore urdhëroi që personi juridik PGP "Vizioni – S" SHPK, të paguajë gjobën në shumë prej 5,000 (pesë mijë) euro.

16. Në arsyetimin e Aktgjykimit P. nr. 1525/2015 Gjykata Themelore deklaroi:

> *„Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësin për veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlersinut të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njërën me tjetrën, në kuptim të nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetoj gjendjen e fakteve të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimit me këto prova materiale".*
>
> *Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në vendin ku ishte duke punuar i ndjeri nuk ka pasur të vendosur masa*

mbrojtëse adekuate për vendin e punës siç janë skelet, mburoja anësore, te cilat po të ekzistonin nuk do të vije deri te fatkeqësia, po ashtu nga raporti i autopsisë është vërtetuar se i ndjeri M. A., ka ndërruar jetë si pasojë e gjakderdhjes së brendshme si rezultat i thyerjes të shumëfishta kockore [...] po ashtu edhe nga raporti :zyrtar i Inspektoratit të Punës në Ferizaj të dt. 04.12.2014, vërtetohet fakti se nga i pandehuri nuk është vepruar në bazë të dispozitës të nenit 5, 6 dhe 7 të Ligjit për siguri në punë dhe shëndet në punë (04/L-161) si dhe nenit 42 të ligjit të punës (03/L-313), për çka edhe inspektorati i punës me dt. 17.12.2014, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën pre 10.000 euro.

„Po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se ndërmarrja nuk ka pasur person përgjegjës për siguri në punë, si dhe fare nuk janë mbajtur trajnime të punëtorëve për siguri në punë ...“

Gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertit nga lëmia e sigurisë në punë dhe mbrojtja në punë i cili ka vërtetuar në njërën anë lëshimet e punëdhënësit si: 1. Punëdhënësi nuk i ka përmbushur obligimet për krijimin e kushteve të sigurta në vendin e punës, 2. Montimi i pllakave të stiroporit në terasa [...] 3. Puna ka qenë e pamundur të fillohet pa u siguruar skelet dhe dhe mburoja e ballkonit, 4. Punëdhënsi është i detyruar që të bëjë trajnimin nga siguria dhe mbrojtja në punë në mënyrë permanente respektivisht për çdo vite, 5. Punëtori i ndjerë Mirsad Ajeti në bazë të të dhënave nuk është trajnuar asnjë herë nga kjo fushë, 6. Nuk ka pajisur punëtorin me (MPM) , mjete personale mbrojtëse adekuate për punësi dhe ditar pune,, 7. Punëtori nuk është pajisur me përshkrimin e punëve dhe detyrave të punës si dhe ditarin e punës, dhe 8. Punëdhënësi nuk ka kryer obligime procedurale pas ndodhjes së rastit, dmth. nuk ka formuar komisionin profesional i cili në raportin e tij do të evidentonte shkaqet e lëndimit.

Nga Raporti Zyrtar Inspektorëve të Punës Nr. Prot. 368/14 të 04.12.2014, në mendimin e tyre pas vizitës në vendin e ngjarjes, analizimit të provave materiale dhe rrethanave në të cilën është shkaktuar fatkeqësia në vend pune, kontrollimit të dokumentacionit dhe analizimit të tyre dhe administrimit të provave tjera relevante, kanë konstatuar se: punëdhënësi nuk ka vepruar sipas dispozitës së nenit 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 04/L – 161 për siguri dhe shëndetin bimor si dhe nenin 42 të Ligjit të Punës nr. 03/L – 212,

Gjatë shqiptimit të dënimit gjykata pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin Sami Nuhaj…"

17. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, brenda afatit ligjor, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës parashtroi ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe të padrejtë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që ta liroj të akuzuarin nga akuza ose ta anuloj dhe ta kthej çështjen penale për rigjykim dhe rivendosje.

18. Më 18 tetor 2018, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PA1. nr. 710/18, me të cilin e aprovoi ankesën e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës, anuloi Aktgjykimin P. nr. 1525/15 të Gjykatës Themelore, dhe e ktheu rastin te e njëjta për rigjykim dhe rivendosje.

19. Në arsyetim, Gjykata e Apelit deklaroi: "*Kolegji penal i kësaj gjykate sipas detyrës zyrtare vlerëson se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nen par 1.12, lidhur me neni 370 par. 1 e lidhur edhe me nenin 366 të KPP-së, ngase aktgjykimi i përpiluar me shkrim nuk është ne përputhje me aktgjykimin e shpallur, ashtu, siç parashihet me dispozitën e 370 par 1 te KPP-ës se "aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jete në përputhje me aktgjykimin e shpallur".*

"Në rastin konkret mungon procesverbali mbi paraqitjen e fjalës përfundimtare të palëve ashtu sikurse që parashihet me dispozitat e lartcekura' e gjithashtu mungon edhe procesverbali mbi shpalljen e aktgjykimit, ashtu sikurse që parashihet me dispozitën e nenit 359 par. 1 dhe par. 2 të KPPK-së. Me qenë se në rastin konkret mungon aktgjykimi burimor. gjegjësisht procesverbali mbi shpalljen e aktgjykimit, kjo gjykatë rrjedhimisht vlerëson se aktgjykimi i përpiluar me shkrim i ekspozuar palëve nuk është identik me aktgjykimin burimor, andaj nga te gjitha këto vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par. 1 të KPPK-së, për çka edhe u dashtë qe i njëjti të anulohet".

20. Më 30 dhjetor 2019, Gjykata Themelore në Ferizaj në procedurën e përsëritur nxori aktgjykimin P. nr. 298/19, me të cilën e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë, duke e dënuar atë me 10 muaj burgim. Ndërsa, për sa i përket

personit juridik PGP "Vizioni – S" SHPK, urdhëroi ta paguaj gjobën në vlerë prej 4,000 (katër mijë) euro.

21. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata Themelore deklaroi; *"... duke vepruar në këtë çështje penale si dhe konform udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, mbajti shqyrtimet gjyqësor sipas këtyre datave 06.06.2019, 23.08.2019, 05.11.2019 dhe 02.12.2019, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues, ndërsa gjyqtari pasi që u bind se i pandehurit e ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 par. 1 KPPK-së, të pandehurit iu ofroj mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.*

I pandehuri Sami Nuhaj në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për asnjë pikë te veprës penale e cila i vihet në barrë.

Nuk është kontestuese se ditën kritike si pasojë e mos ndërmarrjes së masave mbrojtëse nga ana e të akuzuarit Sami Nuhaj, gjatë punimeve në objektin i cili gjendet në rrugën "Astrit Bytyqi" në Ferizaj, e datës 29.11.2014 rreth ores 15:00, nga kati i 8 ku i ndjeri Mirsad Ajeti ka qenë duke punuar ka rënë në tokë me ç'rast ka humbur jetën, gjendja e tij faktike u vërtetua nga dëgjimi i dëshmitarit të sipër cekur të cilët në shqyrtimin gjyqësor të datës 05.11.2019 deklaruan se objekti ku të njëjtit kanë qenë duke punuar një kohë të gjatë edhe për kundër faktin se është dashur të ketë të vendosura mburoja anësore-skele në të gjitha anët e objektit ne rastin konkret në njërën anë pikërisht në vendin ku ka qenë duke punuar tani i ndjeri nuk ka pasur të vendosura fare skele prandaj edhe ka ardhur deri te fatkeqësia, nga dëshmitarët e dëgjuar u vërtetua se mburojat anësore-skelet ka pasur për obligim t'i siguroj pronari i kompanisë pra i pandehuri Sami Nuhaj, i cili sipas dëshmitarit Abedin Haxhijaj ka qenë i njoftuar për këtë fakt por që të njëjtat nuk i ka siguruar.

Gjendja faktike si në diapozitiv të aktakuzës u vërtetua edhe nga eksperti për mbrojtje dhe siguri në vende pune Hysen Hysenaj, i cili ka deklaruar mbi bazën e ligjit për sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit në punë 04/L-161, neni 5 pika 1,3,4 dhe neni 6 pika 1,2,3 përgjegjësia primare dhe kryesore lidhur me rastin bie mbi ndërmarrjen NPN "Vizioni-S" sh.p.k, ndërsa mbi bazën e po të njëjtit ligj neni 21 pika 1 dhe 2 deri në pikën 2,5 dhe pika 3 dhe 4 përgjegjësia sekondare bie mbi punëmarrësin. Ndërsa nga plotësimi i ekspertizës të sqaruar në lidhje me pretendimet e mbrojtjes eksperti ka vërtetuar se mburoja-skelet është dashur të jenë të vendosura në tërë objektin aty ku paraqitet rrezik për jetën dhe

shëndetin e punëtorëve, ndërsa sa i përket punëve që është dashur të kryen në ditën kritike kjo nuk ka mundur të dihet pasi që nuk ka ekzistuar plani punët për atë ditë.

Se i pandehuri nuk ka vepruar në pajtim me ligjin për siguri në punë dhe shëndet vërtetohet edhe nga raporti zyrtar i inspektoratit në Ferizaj të datës 04.12.2014, nga i cili është konstatuar se deri tek aksidenti në punë me pasojë vdekje të punëtorit është ardhur për shkak se është lejuar nga ana e punëdhënësit që të punoj në montimin e pllakave të stiroporit ne terras të jashtme pa vendosur skele dhe masa tjera mbrojtëse si dhe punëtori nuk ishte i pajisur me litar mbrojtës ashtu si pasojë e mos ndërmarrjes edhe të këtyre masave ka ardhur deri tek vdekja fatale e tij".

22. Kundër Aktgjykimit P. nr. 298/19 të Gjykatës Themelore brenda afatit ligjor, ankesa u parashtrua nga mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e kontestuar dhe ta shpallë të akuzuarin të pafajshëm dhe ta kthejë rastin në rigjykim dhe rivendosje.

23. Më 14 korrik 2020, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PA1. nr. 129/2020, duke refuzuar ankesën e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

24. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata e Apelit deklaroi:

> ***a)*** Sa i përket pretendimeve të avokatit mbrojtës të parashtruesit të kërkesës se aktgjykimi i kontestuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, duke shtuar se aktgjykimi nuk përmban arsye për faktet vendimtare ...", Gjykata e Apelit konstatoi „ *pretendimet e lartë cekura nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale për te cilat pretendohet ne ankesën e mbrojtësit të akuzuarit dhe as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së. Aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, në arsyetimin e aktgjykimit te kundërshtuar gjykata e shkallës se parë drejte ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar. Gjykata e shkallës së parë provat i ka vlerësuar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par 6 dhe 7 të KPPK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose të pa provuara ".*

b) Në lidhje me pretendimet për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe mënyrës së vlerësimit të provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor, si dhe gjetjet e ekspertit H. H., Gjykata e Apelit konkludoi, "*se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, nuk qëndrojnë. Sipas shkresave te çështjes dhe aktgjykimit të ankimuar edhe gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkalles se pare dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se ne këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje siç pa të drejt pretendohet ne ankesën e ushtruara kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 365 të KPP-së, e ka shpall fajtor të akuzuarin Sami Nuhaj, për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 367 par. 2 lidhur me par. 7 dhe 3 të KPRK-së*".

c) Sa i përket pretendimeve ankimore të mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e Kodit Penal, përkatësisht se gjykata e shkallës së parë kishte aplikuar gabimisht dispozitat e Kodit Penal, duke aplikuar analogjinë në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 3 të KPPK-së, dhe se në mënyrë të gabuar ka aplikuar dispozitat e nenit 367 të KPPK-së, Gjykata e Apelit konkludoi se, *"Nuk qëndron pretendimi ankimor i mbrojtësit të akuzuarit se gjykata të akuzuarin e ka shpall fajtor në bazë të analogjisë dhe duke shkelur në mënyrë flagrante parimin e legalitetit. Sipas nenit 367 par. 2 të KPPK-së, përcaktohet „Kushdo që është përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës dhe i cili nuk i instalon pajisjet mbrojtëse, nuk i mirëmban ato në gjendje të rregullt për punë, nuk siguron përdorimin e tyre kur është e nevojshme apo nuk vepron në pajtim me dispozitat apo rregullat teknike mbi masat për sigurinë në vendin e punës dhe me këtë rrezikon jetën e njerëzve ose shkakton dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet".Pra sipas kësaj dispozite kryesi i kësaj vepre penale cilësohet kushdo që është përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës, i cili person përgjegjës parashihet sipas Ligjit nr. 04/L161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë konkretisht nenin 10, sipas të cilit nen në paragrafin 1 të tij përcaktohet "Punëdhënësi i cili punëson deri në pesëdhjetë (50) të punësuar, nëse është i aftë/kompetent, mund të marrë vetë përgjegjësinë për zbatimin e masave të përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 9 të këtij ligji, me kusht që t'i plotësojë kushtet dhe kriteret sipas paragrafit 5. të nenit 9 të këtij ligji", andaj sipas kësaj dispozite është i drejte konkludimi i gjykatës së shkallës së parë kur të akuzuarin Sami*

Nuhaj e ka shpall fajtor dhe përgjegjës për veprën penale e cila i vihet në barrë".

25. Kundër Aktgjykimit PA1. nr. 129/2020 të Gjykatës së Apelit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë parashtroi mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës për shkak të shkeljes së ligjit penal me propozim që kërkesa të aprovohet dhe të anulohen aktgjykimet e kontestuara, si dhe ta kthejë çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës të parë si dhe ta liroj të akuzuarin nga akuza.

26. Më 16 dhjetor 2020, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin PML. nr. 325/2020, përmes të cilit e refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

27. Në arsyetimin e aktgjykimit PML. nr. 325/2020 Gjykata Supreme deklaroi:

i) Sa i përket pretendimit të avokatit mbrojtës të parashtruesit të kërkesës se të dy aktgjykimet janë nxjerrë me shkelje të ligjit penal, dhe se shkelja konsiston në faktin se Sami Nuhaj ishte dënuar gabimisht si person përgjegjës për sigurinë në punë, Gjykata Supreme konkludoi *"Siç rezulton nga shkresat e çështjes i dënuari Sami Nuhaj është pronar dhe person përgjegjës në Ndërmarrjen "Vizioni-S", e Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, në nenin 5 paragrafi 1 të këtij ligji, përcakton se punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës. Në rastin konkret punëdhënës është i dënuari Sami Nuhaj i cili konform përkufizimeve nga neni 3 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë është personi fizik apo juridik i cili siguron punë për një ose më shumë të punësuar, i paguan të punësuarit për punën ose shërbimet e kryera dhe është përgjegjës për subjektin punues. Pra, sipas këtyre dispozitave i dënuari si punëdhënës ishte edhe person përgjegjës për siguri dhe shëndet në ndërmarrjen pronar i së cilës ishte vet.*

Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se nga këto që u thanë më lartë i dënuari është punëdhënës dhe njëkohësisht edhe personi përgjegjës, sepse i njëjti konform nenit 10 paragrafi 1 të ligjit të lart cekur, ka punësuar deri në 50 punëtorë, që nuk është kontestuese, sepse edhe ditën kritike në vend punishte kanë qenë 30 punëtorë dhe i njëjti ka mundur vetë të marrë përgjegjësi për zbatimin e masave te përcaktuara nga paragrafi 1 i nenit 9, pra, ka qenë përgjegjës për zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në vend punishte...."

ii) Sa i përket pretendimit të avokatit mbrojtës të parashtruesit të kërkesës se Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë përcakton sanksionet administrative për kompanitë që punësojnë deri në 50 punëtorë dhe nuk ka asnjë person përgjegjës për sigurinë në punë, dhe se kjo mangësi sanksionohet vetëm me masa administrative dhe jo përgjegjësi penale, Gjykata Supreme konstaton, *„se shqiptimi i gjobave si masë administrative janë masë për përgjegjësinë e personit juridik, ndërkaq i dënuari mban përgjegjësi penale për pasojat e shkaktuara si person përgjegjës i ndërmarrjes. Po ashtu, kjo gjykatë gjen se drejt është zbatuar ligji penal kur i njëjti është shpallur fajtor për shkak të veprës penale asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikim i sigurisë në vendin e punës nga neni 367 par.2 lidhur me par.3 dhe 7 të KPK, sepse nga veprimet e tij e sidomos nga fakti se i njëjti përkundër qe ka qenë i vetëdijshëm për rrezikun në punë për të punësuarit e tij dhe si person përgjegjës, nga pakujdesia nuk kishte ndërmarrë asgjë që sipas rregullave teknike për siguri në punë t'i siguroj të punësuarit e aq më tepër duke u nisur nga fakti se ne objektin - punishten edhe pse ka pas skele të vendosura por jo në tërë objektin, ka lejuar që të punësuarit të punojnë në pjesën e cila nuk ka pasur kushte teknike (skele te vendosura) për atë lloj pune. Pra, kjo gjykatë gjen se i dënuari nuk i kishte zbatuar rregullat teknike të sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë si person përgjegjës dhe për pasojë të mos zbatimit të këtyre rregullave kishte ardhur edhe deri tek humbja e jetës së tani të ndjerit e çka përcakton edhe lidhjen kauzale në mes të veprimeve-mos veprimeve të tij dhe pasojës së shkaktuar“.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon që në procedurën penale Gjykata Supreme ka shkelur parimin e procedurës gjyqësore dhe ka zbatuar ligjin në mënyrë arbitrare, duke shkelur të drejtat e tij individuale të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionaliteti në Rastet Penale] të Kushtetutës, si dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së.

29. Sa i përket shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson dy pretendime, përkatësisht interpretimin e gabuar të ligjit, dhe aktgjykimin e paarsyetuar të Gjykatës Supreme.

30. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës shton se Gjykata Supreme e Kosovës ka zbatuar në mënyrë arbitrare nenin 5, paragrafi 1 dhe nenin 10 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë të cilët parashohin *„Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës”*.

31. Për më tepër, në lidhje me aktgjykimin e paarsyetuar, parashtruesi i kërkesës pretendon që neni 370, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale në mënyrë të qartë parashikon detyrimin që autoritetet gjyqësore të arsyetojnë vendimet, por që Gjykata Supreme e Kosovës duke zbatuar në mënyrë arbitrare dispozitat e Kodit Penal ka sjellë në situatën që Aktgjykimi PML. nr. 325/2020 nuk është i arsyetuar.

32. Në mbështetje të pretendimit për aktgjykim të paarsyetuar, parashtruesi i kërkesës gjithashtu citon dy paragrafë të aktgjykimeve të Gjykatës në rastet KI 93/16 dhe KI 87/18.

33. Parashtruesi i kërkesës shton se Gjykata Supreme në aktgjykim nuk ofron arsye të vlefshme për “karakterizimin e z. Sami Nuhaj si person përgjegjës për sigurinë në punë, por që në rastin e tij u zbatua analogjia. Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë nr. 04/L - 166, neni 3, pika 1. 10 parasheh që personi përgjegjës për sigurinë në punë të përcaktohet si më poshtë: *„Personi i ngarkuar për sigurinë dhe shëndetin në punë - profesionist i cili është i punësuar te punëdhënësi dhe është i caktuar për të kryer detyra që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë“. Pra, për të pas një person statusin e personit përgjegjës për siguri në punë duhet të jetë a) profesionist; b) I punësuar: c) të jetë caktuar për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë në punë. Me asnjë provë të vetme të administruar në shqyrtimin gjyqësor nuk u vërtetua se z. Sami Nuhaj si pronar i Kompanisë ti ketë cilësitë e kërkuara për fituar epitetin e personit përgjegjës për siguri në punë”*.

34. Si pretendim të dytë, parashtruesi i kërkesës thekson shkeljen e nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të KEDNJ-së, duke deklaruar se askush nuk mund të shpallet fajtor ose i dënuar për një vepër penale e cila, në kohën e kryerjes së saj, nuk ishte përcaktuar me ligj si vepër penale, prandaj është e qartë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës afirmon parimin *„Nullum crimen, nulla poena sine lege qerta“*, dhe kjo do të thotë që elementet e krimit dhe dënimit në fjalë duhet të përcaktohen qartë me ligj. Ndërsa sipas nenit 7 të KEDNJ-së, *elementet e krimit dhe dënimi përkatës duhet të përcaktohen qartë në ligj. Kjo kërkesë plotësohet kur nga formulimi i dispozitës përkatëse, dhe në rast se është nevoje me interpretimin nga ana e gjykatës, individi ka*

mundësi të dijë se cilat veprime apo mosveprime do ta bëjnë atë penalisht përgjegjës".

35. Në kontekstin e mësipërm, parashtruesi i kërkesës shton se në mungesë të përcaktimit të personit përgjegjës për siguri në punë, gjykatat aplikuan analogjinë në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 3 të Kodit Penal, sipas të cilit: "*Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë*" (Ligji Nr. 04/L-082) dhe si pasojë ngarkoi pronarin e kompanisë "Vizioni – S" me përgjegjësi penale pa ndonjë bazë faktike dhe ligjore.

36. Parashtruesi i kërkesës kërkon që të mbahet një seancë publike.

37. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon që Gjykata të vendosë masë të përkohshme në mënyrë që të pezullohet ekzekutimi i aktgjykimit të Gjykatës Supreme, dhe në mbështetje të këtij pohimi ai shton:

> *„Kjo kërkesë përmbush të gjitha kushtet për tu shqyrtuar dhe miratuar nga Gjykata pasi që është me shkrim, mbështetet në fakte të dëshmuara të rastit, ofron argumente juridike mbështetëse dhe tregon për pasojat e paripërueshme që Parashtruesi do të pësonte pa caktimin e masës së përkohshme ".*
>
> *„Në raste të ngjashme, ku dëm i riparueshëm do të shkaktohej pa masën e përkohshme, kjo Gjykatë e nderuar ka lëshuar vendime për masë të përkohshme. Shih p.sh. Tomë Krasniqi v. RTK dhe KEK, KI 11109 (16 tetor 2009); Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë v. Kuvendi Komunal i Prizrenit, KI 56/09 (15 dhjetor 2009); Bajrush Xhemajli KI 78/12. Prandaj, edhe Gjykata Kushtetuese ka pranuar që rastet e këtilla meritojnë shqyrtim përmbajtjesor para se te ekzekutohet një aktgjykim që do të sillte dëme të paripërueshme për parashtruesit.."*

38. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë që "*Të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të Parashtruesit të garantuara me Nenin 31 dhe 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Nenin 10 të Deklaratës Universale, dhe Nenin 6 dhe 7 të Konventës Evropiane, si rezultat i shkeljeve nga Gjykata Supreme te një mori të drejtash të garantuara për Parashtruesin me këto instrumente dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës".*

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore
Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 33
[Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]

1. "Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.

2. Dënimi i shqiptuar për një vepër penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës. 3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale. 4. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës."

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale

në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

Neni 7
(Nuk ka dënim pa ligj)

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.
2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara".

Dispozitat përkatëse ligjore

LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. Punëdhënësi – personi fizik apo juridik i cili siguron punë për një ose më shumë të punësuar, i paguan pagën të punësuarit/ve për punën ose shërbimet e kryera dhe është përgjegjës për subjektin punues;

1.2. I punësuari - personi fizik i cili kryen punë ose shërbime me pagesë për punëdhënësin dhe ka marrëdhënie punësimi me punëdhënësin;

1.3. Siguria dhe shëndeti në punë – pjesë përbërëse e organizimit të procesit të punës, duke ndërmarrë masat parandaluese, që kanë synim përmirësimin e kushteve të punës, mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, përmirësimin e

ambientit të punës, mbrojtjen fizike dhe psikike të punësuarëve dhe të tjerëve që marrin pjesë në procesin e punës;

1.4. Rrezik – mundësia që të punësuarit t'i shkaktohet plagë, sëmundje ose probleme shëndetësor të menjëhershme apo të mëvonshme, si rezultat i ekspozimit në ambientin e punës ku paraqiten elemente të dëmshme kimike, fizike dhe biologjike, mjeteve të punës dhe makinerive pa pajisje mbrojtëse dhe të pasigurta për përdorim, mënyrës së gabuar të përdorimit të mjeteve të punës dhe makinerive si dhe mënyrës së gabuar të organizimit të punës;

1.5. Rrezik i mundshëm dhe serioz - veprimtari e identifikueshme, që paraqet rrezik, dhe e cila në një periudhë të shkurtër kohore mund të shkaktojë dëme materiale ose në njerëz;

1.6. Sëmundje profesionale - çdo sëmundje e shkaktuar nga ekspozimi në elementet e dëmshme dhe të rrezikshme kimike, fizike dhe biologjike në ambientin e punës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës;

1.7. Masat parandaluese - të gjitha veprimet e ndërmarra dhe të planifikuara në të gjitha proceset e punës në subjektin punues për të evituar dhe minimizuar rreziqeve që shkaktohen nga ushtrimi i veprimtarisë së punës;

1.8. Vendet e punës - përfshijnë të gjitha vendet dhe hapësirat nën mbikëqyrjen direkte dhe indirekte nga punëdhënësit ku të punësuarit duhet të kryejnë aktivitete pune dhe të qëndrojnë gjatë procesit të punës;

1.9. Dokument i vlerësimit të rrezikut - dokumenti ku përshkruhen karakteristikat e procesit të punës, identifikimi i burimit të rrezikut, përcaktimi kush mund të rrezikohet, nga çfarë rrezikohet dhe si, vlerësimi i rrezikut për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe përcakton masat e nevojshme dhe të domosdoshme, që duhet të ndërmerren për t'i përparuar këto masa në pajtim me rivlerësimet që do të bëhen kohë pas kohë;

1.9. Personi i ngarkuar për sigurinë dhe shëndetin në punë - profesionist i cili është i punësuar te punëdhënësi dhe është i caktuar për të kryer detyra që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë;

1.11. Persona ose shërbime të specializuara – personat fizikë ose juridikë, jashtë subjekteve punuese të kualifikuar dhe të licencuar, për të kryer veprimtarinë nga siguria dhe shëndeti në punë në pajtim me këtë ligj;

1.12. Aksident në punë ose për shkak të punës - çdo ngjarje të papritur gjatë procesit të punës, që shkakton dëmtimin të menjëhershëm trupor të të punësuarit/ve, dëmtim që sjell paaftësi të përkohshme, paaftësi të përhershme ose që sjell vdekje, si dhe çdo dëmtim tjetër të shëndetit që lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e veprimtarisë së punës;

1.13. Inspektorati i Punës – trup ekzekutiv i MPMS që mbikëqyr zbatimin e legjislacionit të punës, përfshirë edhe këtë ligj.

1.14. Ministria - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Kreu II
Detyrimet e Punëdhënësit

Neni 5
Parimet e përgjithshme për punëdhënësin

1. Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës.

Neni 10
Të punësuarit e ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë

1. *Punëdhënësi i cili punëson deri në pesëdhjetë (50) të punësuar, nëse është i aftë/kompetent, mund të marrë vetë përgjegjësinë për zbatimin e masave të përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 9 të këtij ligji, me kusht që t'i plotësojë kushtet dhe kriteret sipas paragrafit 5. të nenit 9 të këtij ligji.*

2. Punëdhënësi i cili punëson mbi pesëdhjetë (50) e më pak se dyqindepesëdhjetë (250) të punësuar, është i detyruar të caktojë një ekspertë, për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.

3. Punëdhënësi i cili punëson më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) të punësuar duhet të angazhojë një (1) ose më shumë

ekspertë për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.

KODI NR. 04/L-082 Kodi penal

Neni 367
Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës
[...]

2. Kushdo që është përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës dhe i cili nuk i instalon pajisjet mbrojtëse, nuk i mirëmban ato në gjendje të rregullt për punë, nuk siguron përdorimin e tyre kur është e nevojshme apo nuk vepron në pajtim me dispozitat apo rregullat teknike mbi masat për sigurinë në vendin e punës dhe me këtë rrezikon jetën e njerëzve ose shkakton dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
[...]

7. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

39. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

41. Gjykata më tej shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, siç parashihet me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afati]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

42. Për sa i përket përmbushjes së kritereve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 325/2020 të 16 dhjetorit 2020, pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu sqaroi të drejtat dhe liritë themelore të cilat pretendon se janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e parashtroi kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

43. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të

cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) parasheh në veçanti:

"Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

44. Rregulli i i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

45. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar ne praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "*të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*". (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkese të vlerësuar si "*qartazi të pabazuar*", edhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si "*qartazi të pabazuara*", Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 do 284).

46. Në këtë kontekst, si dhe më poshtë, në mënyrë që të vlerësohet pranueshmëria e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e këtij rasti, në mënyrë që të vlerësojë nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

47. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata rikujton që thelbi i rastit lidhet me faktin se, në pajtim me vendimet e gjykatave të rregullta, parashtruesi i kërkesës si person përgjegjës, përkatësisht pronari i ndërmarrjes ndërtimore „Vizioni – S“ SHPK, ka kryer veprën penale *„asgjësim, dëmtim ose heqje e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikim i sigurisë në vendin e punës nga neni 367 par. 2 lidhur me par. 7 dhe 3 të KPRK-së*, sepse ai nuk ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë siç përcaktohet me ligjin për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve, që rezultoi me vdekjen e njërit prej punëtorëve në vendin e punës.

48. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës konteston gjetjet e Gjykatës Supreme, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 7 (Nuk ka dënim pa ligj) i KEDNJ-së.

Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

49. Sa i përket shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron që Gjykata Supreme **i)** zbatoi në mënyrë arbitrare nenin 5, paragrafi 1 dhe nenin 10 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Puna, dhe **ii)** që aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ishte arsyetuar në pajtim me kërkesën e nenit 370, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale në lidhje me karakterizimin e tij si person përgjegjës për sigurinë në punë, siç parashihet në nenin 3 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

i) Pretendimet për zbatim arbitrar të nenit 5, paragrafi 1 dhe nenit 10 të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë

50. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar dhe interpretimin e së drejtës materiale, në rastin konkret *neni 5, paragrafi 1 dhe neni 10 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë*, Gjykata dëshiron të vë theksin në qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata rithekson më tej se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e “shkallës së

katërt" në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Në të vërtet është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih: *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI68/16, parashtrues: *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, paragrafi 51 dhe 52, rastin KI70/11, parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29).

51. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata vëren se për parashtruesin e kërkesës është problematik pikërisht fakti që Gjykata Supreme ka zbatuar nenin 5, paragrafi 1 dhe nenin 10 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë kur përcaktoi statusin e tij juridik si person përgjegjës, i cili duhet të sigurojë kushte shëndetësore dhe të sigurisë për punëtorët, që çoi në përfundimin se ai duhet të dënohej për krimin për të cilin ngarkohet.

52. Gjykata së pari rikujton që Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vendosur nëse parashtruesi i kërkesës ishte fajtor apo jo për kryerjen e një vepre penale. Ajo as nuk ka juridiksion për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë ose për të vlerësuar nëse gjykatat e rregullta kanë pasur prova të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e parashtruesit të kërkesës. (Shih: rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI68/16, parashtrues: *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, paragrafi 50).

53. Gjykata Kushtetuese, mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të drejtë ose jo arbitrar (shih: *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI68/16, parashtrues: *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, paragrafi 54, dhe KI70/11, parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 30).

54. Duke iu kthyer rastit konkret dhe pretendimit ankimor të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton, se parashtruesi i kërkesës ishte dënuar me një aktgjykim të formës së prerë si një person përgjegjës i cili nuk ka ndërmarrë të gjitha masat e sigurisë në vendin e ndërtimit siç parashihet në nenin 5 dhe nenin 10 të Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, ku kompania e tij kreu punë ndërtimore, në të cilën një nga punëtorët e kishte humbur jetën. Gjykata rikujton që nenet e lartpërmendura të ligjit theksojnë:

Neni 5

"1. Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës".

Neni 10 paragrafi 1

"1. Punëdhënësi i cili punëson deri në pesëdhjetë (50) të punësuar, nëse është i aftë/kompetent, mund të marrë vetë përgjegjësinë për zbatimin e masave të përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 9 të këtij ligji, me kusht që t'i plotësojë kushtet dhe kriteret sipas paragrafit 5. të nenit 9 të këtij ligji".

55. Duke iu referuar dispozitës ligjore me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton se parashtruesi nuk e fitoi statusin e një personi përgjegjës para Gjykatës Supreme siç deklaroi ai në kërkesë, por që një përfundim i tillë u arrit nga Gjykata Themelore në procedurën e përcaktimit të përgjegjësisë së tij penale, me ç'rast u prezantuan provat, u dëgjuan dëshmitarët, u angazhuan ekspertë të gjykatës, dhe si rezultat i këtyre veprimeve, Gjykata Themelore përfundoi *"se ligji i sigurisë në punë e përcakton se nëse një kompani i ka 50 e më shumë punëtorë, duhet të ketë një person përgjegjës për siguri në punë, në të kundërtën, kur këto nuk janë të caktuar te një individ ato barten te një person përgjegjës. Sami Nuhaj ishte drejtor i kompanisë, [...], drejtori i kompanisë nuk është personi i drejtpërdrejtë por nuk do të thotë se nuk ka përgjegjësi në siguri dhe në vend punishte".*

56. Në të vërtetë, Gjykata mund të konkludojë se bazuar në sa më sipër Gjykata Themelore e karakterizoi parashtruesin e kërkesës si person përgjegjës i cili ishte i detyruar të krijonte kushte të sigurisë në vend punishte, që në vetvete nënkupton jo vetëm sigurimin e masave teknike dhe pajisjeve, por ofrimin e trajnimit adekuat, me qëllim të aftësimit të punëtorëve për siguri në punë, gjë që ai nuk e bëri në pajtim me gjetjet e gjykatës, si dhe në bazë të vet deklaratës së tij në gjykim *"se personat e caktuar për siguri në punë nuk kanë pasur kualifikime adekuate përveçse përvojë në punë".*

57. Duke e pasur parasysh këtë, Gjykata Themelore vendosi që parashtruesi i kërkesës, si person përgjegjës i drejtpërdrejtë, në pajtim me nenin 5 dhe nenin 10 të Ligjit për Siguri dhe Shëndet, ka kryer veprën penale në pajtim me nenin 367 të KPPK, për të cilën ai u dënua me burgim.

58. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës ngriti po ato pretendime ankimore para Gjykatës së Apelit duke kontestuar statusin

e tij si person përgjegjës, duke theksuar faktin *"ligjdhënësi në nenin 367 ka përcaktuar si subjekt të kryerjes së kësaj vepre penale personi përgjegjës për siguri në punë, dhe jo pronar, apo drejtori i kompanisë"*.

59. Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit i kushtoi vëmendje të posaçme pretendimit të parashtruesit të kërkesës në lidhje me statusin e tij si person përgjegjës, duke arritur në përfundimin se përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë i takon punëdhënësit - pronarit, i cili është dashur të krijonte kushte sigurie, ose ta autorizoj një punonjës për të kryer aktivitete të sigurisë dhe shëndetit në punë, gjë që ai nuk e bëri në rastin konkret, në të vërtetë, me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari autorizoi dikë për të kryer veprimtari të sigurisë dhe shëndetit në punë, siç përcaktohet me Ligjin nr. 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe se për këtë arsye, *pretendimet ankimore në këtë drejtim, sipas mendimit të këtij kolegji, janë të pabazuara.*

60. Në lidhje me procedurën në Gjykatën Supreme, Gjykata gjithashtu konstaton se parashtruesi ka iniciuar dy pretendime kryesore ankimore, nga të cilët i pari kishte të bënte me faktin "*se gjykatat gabimisht kanë zbatuar nenin 10 par. 1 të Ligjit për Siguri në Punë, sepse në ndërmarrje kanë ekzistuar personat përgjegjës për siguri në punë. Andaj , në ndërmarrje ka pasur persona përgjegjës por edhe po mos të kishte persona të tillë, vetë mos emërimi i personave përgjegjës për siguri në punë nuk është element i veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor"*. Edhe pretendimi tjetër ankimor që kishte të bënte me faktin se Ligji për mbrojtjen dhe sigurinë në punë përcaktonte sanksione administrative dhe jo penale, në rast se një kompani që punëson deri në 50 punëtorë nuk ka persona përgjegjës për sigurinë në punë.

61. Gjykata nuk mund të mos vërejë që Gjykata Supreme trajtoi të dy pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës me ç'rast konkludoi ***i)*** se i dënuari ishte punëdhënës dhe të njëjtën kohë edhe person përgjegjës, sepse i njëjti në pajtim me nenin 10, paragrafi 1, të ligjit të mësipërm, ai punësoi deri në 50 punëtorë, gjë që nuk është kontestuese, sepse në ditën kritike kishte 30 punëtorë në vend punishte dhe i njëjti ka mundur vet të merrte përgjegjësi për zbatimin e masave të caktuara në paragrafin 1 të nenit 9, prandaj, ai ishte përgjegjës për zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në vendin e ndërtimit. Ndërsa në lidhje me pretendimin e dytë ankimor përkitazi me faktin se ligji parashikon dënime administrative dhe jo përgjegjësi penale, qëndrimi i Gjykatës Supreme ishte *„se shqiptimi i gjobave si masa administrative janë masa për përgjegjësinë e personit juridik,*

ndërsa në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës mban përgjegjësi penale për pasojat e shkaktuara si person përgjegjës i ndërmarrjes".

62. Duke pasur parasysh të gjitha të lartcekurat, Gjykata i hedh poshtë si pretendime të shkallës së katërt pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me zbatimin arbitrar të nenit 5 paragrafi 1 dhe nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë në lidhje me statusin e tij si person përgjegjës.

ii) Pretendimet që aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ishte arsyetuar në pajtim me kërkesën e nenit 370, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale

63. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ishte arsyetuar në pajtim me nenin 370, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me karakterizimin e tij si person përgjegjës për sigurinë në punë, siç kërkohet me nenin 3 të Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë.

64. Gjykata rikujton që neni 370 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale, në të cilin është thirrur parashtruesi i kërkesës, rregullon formën dhe përmbajtjen e një aktgjykimi, gjë që, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, nuk ka ndodhur kur është fjala për Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, veçanërisht kur bëhet fjalë për arsyetimin në lidhje me karakterizimin e tij si person përgjegjës për siguri siç përcaktohet në nenin 3 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

65. Gjykata rikujton që neni 370 paragrafi 1 i KPP-së në pjesën përkatëse thekson:

Neni 370 Përmbajtja dhe forma e aktgjykimit me shkrim

> "*1. Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë në përputhje me aktgjykimin e shpallur. Aktgjykimi përfshinë hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin.*"

66. Gjykata shton se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19

shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës,* Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.

67. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri,* Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, *Muharrem Blaku dhe të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; dhe KI24/17 parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 17 majit 2019.

68. Në parim, praktika gjyqësore e GJENDJ-së dhe ajo e Gjykatës theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet "të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ato bazuan vendimin e tyre". Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.

69. Duke iu kthyer pretendimit specifik ankimor të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj konstatoi se „*i dënuari Sami Nuhaj është pronar dhe person përgjegjës në Ndërmarrjen "Vizioni-S", e Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, në nenin 5 paragrafi 1 të këtij ligji, përcakton se punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës. Në rastin konkret punëdhënës është i dënuari Sami Nuhaj i cili konform përkufizimeve nga neni 3 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë është personi fizik apo juridik i cili siguron punë për një ose më shumë të punësuar, i paguan të punësuarit për punën ose shërbimet e kryera dhe është përgjegjës për subjektin punues. Pra, sipas këtyre dispozitave i dënuari si punëdhënës ishte edhe person përgjegjës për siguri dhe shëndet në ndërmarrjen pronar i së cilës ishte vet".*

70. Gjykata, duke lidhur pretendimet e parashtruesit të kërkesës me praktikën e saj gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si

dhe me kërkesat e nenit 370, paragrafi 1 i KPP-së, është e mendimit se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me aktgjykimin e paarsyetuar të Gjykatës Supreme përkitazi me karakterizimin e tij si person përgjegjës për siguri janë të pabazuara. Gjykata arriti në një përfundim të tillë, saktësisht me një analizë të hollësishme të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në lidhje me faktet vendimtare në të cilat Gjykata Supreme bazoi përfundimin e saj në lidhje me përmbushjen e kushteve që përcaktojnë statusin e tij si person përgjegjës.

71. Bazuar në të lartcekurat, rrjedh që pretendimet e parashtruesit të kërkesës për aktgjykim të paarsyetuar të Gjykatës Supreme janë qartazi të pabazuara për shkak të faktit se gjykatat e rregullta kanë respektuar parimet dhe garancitë e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së sa i përket çështjes së vendimit të arsyetuar gjyqësor.

Pretendimet për shkelje të nenit 33 të Kushtetutës, si dhe nenit 7 të KEDNJ-së

72. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës së pari thekson se Gjykata Supreme në këtë rast zbatoi analogjinë në kundërshtim me nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 2, paragrafi 3 të Kodit Penal, sepse dispozita e nenit 367, paragrafi 2, e cila merret me personin përgjegjës për sigurinë në punë, interpretoi me analogji për personin përgjegjës të kompanisë. Prandaj, parashtruesi i kërkesës pretendon që askush nuk mund të shpallet fajtor ose i dënuar për një vepër penale e cila, në kohën e kryerjes së saj, nuk ishte përcaktuar me ligj si vepër penale. *„Nullum crimen, nulla poena sine lege qerta“* siç ishte rasti me të.

73. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton se në dritën e rrethanave të rastit në fjalë dhe pretendimeve, duhet të bëhet vlerësimi i kushtetutshmërisë së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për interpretim dhe zbatim qartazi arbitrar të ligjit për shkak të zbatimit të analogjisë nga gjykatat e rregullta, e cila hyn në kornizën e të drejtave të garantuara me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) i KEDNJ-së dhe zbatimi i tij, i interpretuar gjerësisht në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së

74. Gjykata rikujton që neni 33 i Kushtetutës garanton një numër parimesh të veçanta, qëllimi i të cilave është të sigurojë sigurinë juridike në një fushë të ndjeshme të së drejtës penale.

75. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se neni 33, paragrafi 1 i Kushtetutës proklamon parimin e legalitetit të veprave dhe dënimeve, përkatësisht sanksionet që ndalojnë, përveç kësaj, efektin prapaveprues të ligjit penal dhe rregulloreve të tjera penale. Sipas parimit të *legalitetit*, *nullum crimen nulla poena sine lege* të cilit i referohej parashtruesi i kërkesës, nënkupton që nuk ka ndonjë vepër penale ose dënim pa ligj. Kjo do të thotë se askush nuk mund të shpallet fajtor për një vepër që, para se të kryhej, me ligj ose rregullore tjetër e bazuar në ligj, nuk ishte parashikuar si e dënueshme, as nuk mund t'i shqiptohet dënimi, i cili nuk ishte parashikuar për atë vepër. Efekti prapaveprues i ligjit penal përjashtohet, sepse dënimi përcaktohet sipas rregullores që ishte e vlefshme në kohën kur është kryer krimi, përveç në ato raste kur rregullimi i mëvonshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës penale (neni 33 paragrafi 4 i Kushtetutës).

76. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës duhet të shqyrtohen në bazë të fakteve dhe provave të mësipërme bashkangjitur kërkesës, në mënyrë që t'i përgjigjet pretendimeve të parashtruesit në lidhje me "*ndalimin e analogjisë në të drejtën penale*" (shih, në mënyrë të ngjashme, rastin KI145/18, parashtrues *Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahimi*, cituar më lart, paragrafi 36).

77. Prandaj, është e nevojshme të vlerësohet kushtetutshmëria e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për interpretim dhe zbatim arbitrar të ligjit si rezultat i përdorimit të analogjisë, duke iu referuar parimeve të *"parimit të legalitetit*" dhe "*ndalimit të analogjisë në drejtësinë penale*" mishëruar në nenin 33 të Kushtetutës, nenin 7 të KEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore përkatëse të GJEDNJ-së.

Parimet e përgjithshme në lidhje me nenin 7 të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së

78. Gjykata thekson se garancia e mishëruar në nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 7 të KEDNJ-së, e cila është një element thelbësor i sundimit të ligjit, zë një vend të theksuar në sistemin mbrojtës të Konventës, siç nënvizohet nga fakti se neni 15 i KEDNJ-së nuk lejon asnjë shmangie nga ai në rast lufte ose rreziku tjetër publik. Siç rrjedh nga objekti dhe qëllimi i tij, ai duhet të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë të tillë që të sigurojë garanci efektive mbrojtëse kundër ndjekjes, dënimit dhe ndëshkimit arbitrar (shih *Korbely kundër Hungarisë [DHM],* kërkesa nr. 9174/02, e 19 shtatorit 2008, paragrafi 69).

79. Prandaj, neni 33 i Kushtetutës dhe neni 7 i KEDNJ-së "*nuk kufizohen në ndalimin e zbatimit retroaktiv të ligjit penal në dëm të të*

akuzuarit: ai, gjithashtu mishëron, më përgjithësisht, parimin se vetëm ligji mund të përkufizojë një vepër penale dhe mund të parasheh një dënim (nullum crimen, nulla poena sine lege) dhe parimin që ligji penal nuk duhet të interpretohet gjerësisht në dëm të të akuzuarit, për shembull me anë të analogjisë. Nga këto parime rrjedh se një vepër penale duhet të përkufizohet qartë në ligj. Ky kusht plotësohet kur individi mund të ketë dijeni nga formulimi i dispozitës përkatëse - dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimit të tij nga gjykatat dhe me këshillën juridike të informuar - për të cilat veprime dhe mosveprime do të jetë penalisht përgjegjës" (shih Aktgjykimin *Korbely kundër Hungarisë*, të cituar më lartë, paragrafi 70).

80. Për më tepër, kur i referohen „ligjit", neni 7 i KEDNJ-së dhe neni 33 i Kushtetutës aludojnë për të njëjtin koncept si ai të cilit i referohet KEDNJ kudo tjetër kur e përdor këtë term, një koncept i cili përfshin të drejtën ligjore dhe gjyqësore dhe nënkupton kërkesa të cilësisë, kryesisht ato të qasshmërisë dhe parashikueshmërisë (shih rastin *EK kundër Turqisë*, kërkesa nr. 28496/95, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 51). Këto kërkesa të cilësisë duhet të përmbushen si në aspektin e përkufizimit të veprës penale, ashtu edhe në aspektin e dënimit të parashikuar për atë vepër (shih Aktgjykimin *Del Rio Prada kundër Spanjës*, kërkesa nr. 42750/09, të 21 tetorit 2013, paragrafi 91).

81. Përveç kësaj, Gjykata shton se, në parim, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta duhet t'i zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit. Kjo gjithashtu vlen edhe atëherë kur e drejta e brendshme i referohet rregullave të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare ose marrëveshjeve ndërkombëtare. Roli i Gjykatës kufizohet në konstatimin nëse efektet e një interpretimi të tillë janë të pajtueshme me Konventën dhe Kushtetutën (shih Aktgjykimin *Waite dhe Kennedi kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 26083/94, e 18 shkurtit 1999, paragrafi 54, shih, gjithashtu, Aktgjykimin *Korbely kundër Hungarisë*, të cituar më lart, paragrafi 72).

Zbatimi i parimeve të lartcekura në rastin e parashtruesit të kërkesës

82. Në dritën e parimeve të lartcekura në lidhje me shtrirjen e mbikëqyrjes së saj, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj të vendosë mbi përgjegjësinë individuale penale të parashtruesit të kërkesës, që është kryesisht çështje e vlerësimit të gjykatave të rregullta. Gjithashtu, nuk është detyrë e Gjykatës të vendosë nëse në

veprimet e parashtruesit të kërkesës ekziston figura e një vepre tjetër penale, kjo gjithashtu është çështje e vlerësimit të gjykatave të rregullta (shih Aktgjykimin *Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë*, kërkesat nr. 34044/96, 35532/97 dhe 44801/98, të 22 marsit 2001, paragrafi 51).

83. Funksioni i Gjykatës, nga këndvështrimi i nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 paragrafi 1 të KEDNJ-së, është që të shqyrtojë nëse vepra penale për të cilën është dënuar parashtruesi i kërkesës është vepër penale e përkufizuar me qasshmëri dhe parashikueshmëri të mjaftueshme dhe nëse gjykatat e rregullta, në kundërshtim me parimin e legalitetit, përmes aplikimit të analogjisë kanë interpretuar gjerësisht ligjin penal në dëm të të akuzuarit (shih Aktgjykimin *Kokkinakis kundër Greqisë*, kërkesa nr. 14307/88, të 25 majit 1993, paragrafi 52).

a) Qasshmëria

84. Sa i përket aplikimit të parimeve të vendosura nga GJEDNJ-ja, Gjykata konsideron se fillimisht duhet të konstatohet nëse ligji penal dhe Ligji për Sigurinë në Punë ishin të qasshëm për parashtruesin e kërkesës në një kohë kur vetë qasshmëria e tyre ishte thelbësore për rezultatin e procedurës.

85. Në këtë drejtim, bazuar në faktet e rastit dhe shkresat e lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ishte drejtor i një kompanie ndërtimore që kryente punë ndërtimore në territorin e Kosovës, dhe se për shkak të vdekjes së njërit prej punonjësve të tij, Prokuroria Themelore në Ferizaj më 3 dhjetor 2015 ngriti aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale *asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 367 par. 2 lidhur me par. 7 dhe 3 të KPRK-së.*

86. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor nga gjykatat e rregullta për kryerjen e kësaj vepre penale në bazë të "*nenit 367, paragrafi 2, në lidhje me paragrafët 7 dhe 3 të KPRK-së*, për çka iu shqiptua edhe dënimi me burg.

87. Gjykata konstaton se gjykatat nxorën aktgjykimet e tyre në bazë të KPK 04/L-082, i cili ishte publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 19/2012, më 13 korrik 2012, dhe Ligjit për Sigurinë në Punë të 31 majit 2013, në bazë të kësaj mund të konkludohet se KPK-ja që parashikonte një vepër penale dhe Ligji për Sigurinë në Punë, i cili parashikonte detyrimin për të përmbushur kërkesat në lidhje me sigurinë në punë, ishin në fuqi në kohën kur kishte ndodhur vepra penale, dhe se ato,

ishin në çdo kohë mjaftueshëm të qasshme për parashtruesin e kërkesës.

b) Parashikueshmëria

88. Gjykata më tej duhet të përcaktojë nëse KPK dhe Ligji për Sigurinë në Punë ishin të parashikueshëm dhe nëse gjykatat e rregullta, duke aplikuar analogjinë, i interpretuan ato në mënyrë të gjerë dhe të paparashikueshme në dëm të parashtruesit të kërkesës.

89. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës themeloi kompaninë e tij ndërtimore dhe se rrjedhimisht, si pronar, ai kishte të drejtat dhe detyrimet e tij, përkatësisht se në pajtim me ligjin në fuqi për sigurinë në punë, ai duhej të ndërmerrte të gjitha veprimet për siguri me qëllim të mbrojtjes së të punësuarve dhe personave të tjerë të cilët mund të dëmtohen drejtpërdrejt ose indirekt nga mos-ndërmarrja e tyre. Për më tepër, neni 10 (Të punësuarit e ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë) të Ligjit për Sigurinë në Punë, parashikonte detyrimin e parashtruesit të kërkesës për të punësuar persona të cilët rregullisht do të mbanin të gjitha trajnimet dhe edukimin e nevojshëm për të gjithë punonjësit në mënyrë që të rrisin masat e sigurisë në punë.

90. Gjykata është e mendimit se parashtruesi i kërkesës ishte i obliguar dhe ka mundur të parashikojë që një lëshim i tillë, përkatësisht mos-përmbushja e kushteve të parapara me dispozitat përkatëse të Ligjit për Siguri në Punë, mund të çonte në përgjegjësinë e tij penale për mosplotësim të të njëjtave, dhe me këtë edhe të veprës penale të paraparë me KPK-në në fuqi.

91. Përveç kësaj, Gjykata konstaton se edhe Gjykata e Apelit gjithashtu është marrë me çështjen e zbatimit të analogjisë në procedurën penale, e cila, sipas parashtruesit të kërkesës, ishte në dëm të tij, dhe me këtë rast konkludoi se "*Nuk qëndron pretendimi ankimor i mbrojtësit të akuzuarit se gjykata të akuzuarin e ka shpall fajtor në bazë të analogjisë dhe duke shkelur në mënyrë flagrante parimin e legalitetit. Sipas nenit 367 par. 2 të KPPK-së, përcaktohet „Kushdo që është përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës dhe i cili nuk i instalon pajisjet mbrojtëse, nuk i mirëmban ato në gjendje të rregullt për punë, nuk siguron përdorimin e tyre kur është e nevojshme apo nuk vepron në pajtim me dispozitat apo rregullat teknike mbi masat për sigurinë në vendin e punës dhe me këtë rrezikon jetën e njerëzve ose shkakton dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet". Pra sipas kësaj dispozite kryesi i kësaj vepre penale cilësohet*

kushdo që është përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës, i cili person përgjegjës parashihet sipas Ligjit nr. 04/L161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë".

92. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta gjatë gjithë procedurës i ishin përmbajtur parimeve të KPK-së, dhe kishin vepruar ekskluzivisht në frymën e dispozitës ligjore, dhe se nuk ishte ardhur deri te zbatimi i analogjisë në të cilën ishte thirrur parashtruesi i kërkesës.

93. Prandaj, Gjykata konkludon se nuk ka pasur shkelje të nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për zbatimin e analogjisë në procedurën penale.

94. Duke pasur parasysh që ajo iu përgjigj të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe as shkelje të parimeve të legalitetit dhe proporcionalitetit në procedurat penale, të garantuara me nenin 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së.

95. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës që të dëshmojë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë dëshmi *prima facie* që tregon shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, i 5 dhjetorit 2013).

96. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për mbajtjen e seancës dëgjimore

97. Gjykata vëren, përveç pretendimeve të tjera në kërkesë, që parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi mbajtjen e një seance publike, pa dhënë ndonjë arsyetim specifik, dhe as arsye pse një seancë publike do të ishte e nevojshme.

98. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit:

"1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës".

99. Gjykata vëren se nuk ka ndonjë arsye në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës në mbështetje të kësaj kërkese.

100. Gjykata vëren se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur mbi këtë çështje në pajtim me formulimin e nenit 20 paragrafi 2 të Ligjit (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI34/17, parashtruese: *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110).

101. Prandaj, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për të mbajtur seancë dëgjimore refuzohet si e pabazuar.

Kërkesa për masë të përkohshme

102. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, e cila do të pezullonte ekzekutimin e aktgjykimit përfundimtar të Gjykatës Supreme.

103. Megjithatë, Gjykata tanimë konstatoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme në baza kushtetuese.

104. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi që kërkesa deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27.1 të Ligjit, dhe rregullat 39 (2) dhe 57 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 mars 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TË REFUZOJË kërkesën për mbajtje të seancës dëgjimore;

III. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

V. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatën Kushtetuese**
Safet Hoxha	Arta Rama-Hajrizi

KI195/19, Parashtrues: Banka për Biznes, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ae.nr.287/18, të 27 majit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr. 330/2019, të 1 gushtit 2019

KI195/19, Aktgjykim i 7 prillit 2021, i publikuar më 2 qershor 2021

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, res judikata, kërkesë e pranueshme, shkelje e të drejtave kushtetuese*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një Kontratë për Kredi dhe Marrëveshjen pasuese për Kolateral, të vitit 2003 bazuar në të cilat, "Nita Commerc" kishte marrë një kredi prej 269.800,00 euro nga parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Banka, me afat kthimi prej dymbëdhjetë (12) muajsh. Duke marrë parasysh që detyrimet e "Nita Commerc" ndaj Bankës nuk ishin kryer bazuar në marrëveshjen në mes palëve, në vitin 2006, kishin filluar procedurat gjyqësore, të cilat kanë rezultuar në një procedurë penale dhe tri procedura kontestimore. Që në fillim të procedurave gjyqësore, Banka kishte pretenduar se "Nita Commerc" nuk i kishte kryer detyrimet e saj, duke kërkuar që të vërtetohet borxhi në vlerë prej 150,000 euro dhe kamata përkatëse. "Nita Commerc", kishte kundërshtuar këto pretendime, duke theksuar, ndër tjerash, se punëtorët e Bankës kishin realizuar ndërhyrje të paautorizuara në llogarinë e saj bankare, duke rezultuar në pagesa të dyfishta në vlerën prej 74,000 euro. Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [VIII.C.Nr.207/06] të 23 nëntorit 2006, kishte miratuar kërkesëpadinë e Bankës, duke e detyruar "Nita Commerc" që të paguajë borxhin kryesorë prej 150,000 euro dhe kamatën përkatëse. E njëjta, bazuar në ekspertizën përkatëse, gjithashtu kishte shqyrtuar pretendimet e "Nita Commerc" lidhur me ndërhyrjen e paautorizuar të punëtorëve të Bankës në llogaritë e saj bankare, duke i refuzuar të njëjtat si të pabazuara. Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, ishte vërtetuar dy herë përmes Gjykatës Supreme, përmes Aktgjykimeve [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 dhe [Rev.E.nr.20/2009] të 17 marsit 2010, respektivisht.

Megjithatë, në dhjetor të vitit 2009, "Nita Commerc" filloi procedurat e reja gjyqësore kundër Bankës. Kësaj radhe, "Nita Commerc", kishte ngritur padi përkitazi me vlerën prej 74.360.00 euro, të cilën kishte pretenduar se Banka e kishte përvetësuar si rezultat i ndërhyrjes së paautorizuar të punëtorëve të saj në llogarinë e saj bankare. Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë përmes Aktvendimit [IV.C.nr.1/2010] të 12 majit 2010 e kishte hedhur poshtë padinë bazuar në nenin 391 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, duke e cilësuar të njëjtën si *res judicata*.

Për më tepër, në dhjetor të vitit 2009 dhe maj të vitit 2010, respektivisht, "Nita Commerc" kishte filluar edhe dy procedura të tjera gjyqësore. Të parën, e kishte filluar përmes një kallëzimi penal kundër Bankës, përkatësisht drejtorit të saj dhe punëtorëve A.Sh., M.B. dhe Sh.K., të cilët i akuzonte për ndërhyrje të paautorizuar në llogarinë e saj bankare dhe përvetësimin e shumës prej 79,786,00 euro. Ndërsa, të dytën, e kishte filluar përmes një padie për "*moslejimin e ekzekutimit*" të Aktvendimit [E.nr.406/09] të 11 nëntorit 2009 të Gjykatës Komunale në Malishevë, i cili kishte lejuar përmbarimin e Aktgjykimit [C.nr. 207/2006] të 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

Përkitazi me procesin penal, kallëzimi penal i 17 majit 2010 i "Nita Commerc", më 4 qershor 2013, kishte rezultuar në Aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve A.Sh., M.B. dhe Sh.K., nga Departamenti për Krime të Rënda i Prokurorisë Themelore, nën dyshimin e kryerjes së veprës penale të përvetësimit gjatë detyrës, siç ishte përcaktuar në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës. Gjithashtu, bazuar në shkresat e lëndës rezulton se Prokuroria Themelore në Ferizaj, kishte ngritur Aktakuzën vetëm ndaj personave A.Sh. dhe M.B. Aktakuza ishte ngritur kundër të dyve, por e njëjta ishte ndryshuar nga Prokurori i Shtetit, duke e tërhequr Aktakuzën përkitazi me personin M.B. Më 31 mars 2016, Departamenti për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore, përmes Aktgjykimit [PKR.nr.209/2015], e kishte liruar nga akuza edhe personin A.Sh. Ky Aktgjykim më pas ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit. Ndërsa, përkitazi me padinë për "*moslejimin e ekzekutimit*" të 19 majit 2010, "Nita Commerc", kishte dorëzuar edhe një parashtresë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, duke kërkuar ndryshimin e kësaj padie në padi për kompenzim dëmi, tashmë në vlerën prej 98,019.43 euro. Gjykata Themelore në Prishtinë, e kishte ndërprerë procedurën kontestimore derisa të përfundojë lënda penale. Më pas ishin zhvilluar edhe dy ekspertiza financiare shtesë dhe ishte konfirmuar se "*nuk ka pasur ndonjë dyfishim të veprimeve bankare*". Për pasojë, Gjykata Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit të dëshmive dhe ekspertizave përkatëse, përmes Aktvendimit [I.EK.nr.424/14] të 2 nëntorit 2018, kishte vendosur që çështja në shqyrtim ishte *res judicata*.

Pas pesë vendimeve të nxjerra në këtë procedurë kontestimore, dy prej të cilave kishin cilësuar kontestin në mes palëve si "*çështje e gjykuar*" bazuar në pikën d) të nenit 391 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, duke vepruar në bazë të ankesës së "Nita Commerc", Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ae.nr.287/18] të 27 majit 2019, i kontestuar në rrethanat e rastit konkret, kishte urdhëruar kthimin e çështjes në rivendosje në merita në Gjykatën Themelore, duke theksuar se kontesti përkatës nuk mund të kualifikohet si *res judicata*. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës drejtuar Prokurorit të Shtetit për të iniciuar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër këtij

Aktvendimi, ishte refuzuar. Bazuar në Aktvendimin e lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, më 1 gusht 2019, përmes Aktvendimit [I.EK.nr.330/19], Gjykata Themelore, kishte refuzuar kërkesën e Bankës që çështja kontestuese të konsiderohet si "*çështje e gjykuar*" dhe kishte proceduar me shqyrtimin e meritave të çështjes.

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës, i konteston këto dy Aktvendime, të Gjykatës së Apelit dhe të asaj Themelore, respektivisht, duke pretenduar se të njëjtat janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke theksuar se në rrethanat e rastit të tij është (i) cenuar parimi i sigurisë juridike; dhe (ii) e drejta në vendim të arsyetuar gjyqësor.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht i ka shtjelluar parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika e saj gjyqësore dhe ajo e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me parimin e sigurisë juridike, përkatësisht, parimin e plotfuqishmërisë së vendimeve të formës së prerë, duke sqaruar, ndër të tjera, se (i) një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon, ndër të tjera, që atëherë kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në dyshim dhe t'i nënshtrohet shqyrtimeve të mëtejme; (ii) asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të plotfuqishëm dhe detyrues gjyqësor thjesht për qëllim të fitimit të mundwsisw sw rishqyrtimit dhe zgjidhjes së freskët të rastit, posaqërisht përmes një "*ankese të maskuar*"; dhe (iii) përjashtime nga një parim i tillë, janë të mundshme vetëm nëse justifikohen nga rrethanat e një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*".

Ndërsa, bazuar në këto parime dhe aplikimin e tyre në rrethanat e rastit konkret, Gjykata shqyrtoi nëse (i) përkitazi me kontestin në mes palëve tashmë ka vendime *res judicata*; (ii) çështja në shqyrtim para Gjykatës së Apelit, ngërthente kufizime *ad personam* dhe të fushëveprimit material; dhe (iii) rihapja e procedurave që tashmë mund të kenë arritur statusin e *res judicata*, nga Gjykata e Apelit, mund të arsyetohet përmes rrethanave të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*".

Gjykata konstatoi se Aktvendimet e kontestuara të Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore, respektivisht, kishin rihapur procedura të cilat tashmë kishin arritur statusin e *res judicata*, përmes Aktgjykimit [VIII.C.Nr.207/06] të 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, siç ishte konfirmuar edhe përmes dy Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, Aktgjykimit [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 dhe Aktgjykimit

[Rev.E.nr.20/2009] të 17 marsit 2010, respektivisht; Aktvendimit [IV.C.nr.1/2010] të 12 majit 2010 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut; dhe Aktvendimit [I.EK.nr.424/14] të 2 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore. Gjykata theksoi se përkundër, dallimeve të caktuara në tri procedurat e ndjekura kontestimore, çështja para Gjykatës së Apelit, nuk kishte kufizime *ad personam* dhe të fushëveprimit material, përkatësisht të gjitha procedurat civile kishin të bënin saktësisht me të njëjtat palë, të njëjtat marrëdhënie juridike dhe të njëjtat rrethana, të cilat ishin thelbësore për vendosjen e kontestit.

Gjykata gjithashtu konstatoi se në rrethanat e rastit konkret, rihapja e këtyre procedurave nuk ishte e justifikuar nga rrethana të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*". Në këtë kontekst, Gjykata theksoi se arsyetimi i Gjykatës së Apelit, përmes Aktvendimit të kontestuar, ndër të tjera, se zhvillimi i një procedure penale paralelisht me procedurën kontestimore e pengonte kualifikimin e çështjes përkatëse civile si *res judicata*, duke theksuar se "*deri më tani nuk dihet epilogu i kësaj procedure penale",* është për më tepër i pasaktë, sepse deri në momentin kur Gjykata e Apelit kishte nxjerrë Aktvendimin e kontestuar, e tërë procedura penale kishte përfunduar përmes dy Aktgjykimeve në procedurë penale e të cilat kishin liruar të akuzuarit, përkatësisht punëtorët e Bankës nga përgjegjësia penale, të cilën "Nita Commerc" dhe Prokuroria përkatëse pretendonin se mbanin.

Prandaj, duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konstatoi se Aktvendimi [Ae.nr.287/18] i 27 majit 2019 i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi [I.EK.nr.330/19] i 1 gushtit 2019 i Gjykatës Themelore, janë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike të mishëruar në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse kanë rihapur vendime të gjykatave që kishin statusin e *res judicata*, pa asnjë justifikim të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*". Si të tilla, të dyja janë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe rrjedhimisht, të pavlefshme.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI195/19

Parashtrues

Banka për Biznes

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ae.nr.287/18, të 27 majit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr. 330/2019, të 1 gushtit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Banka për Biznes Sh.A. (në tekstin e mëtejmë: Banka), e përfaqësuar me autorizim nga Sahit Bajraktari (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Ae.nr.287/18] e 27 majit 2019 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktvendimin [I.EK.nr. 330/2019] e 1 gushtit 2019 të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

3. Aktvendimin [Ae.nr.287/18] e 27 majit 2019 të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 25 qershor 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimeve të kontestuara, të cilat pretendohet të jenë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 24 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 31 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.

8. Më 20 janar 2020, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzonte autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.

9. Më 28 janar 2020, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi në Gjykatë autorizimin e kërkuar.

10. Më 29 janar 2020, Gjykata e njoftoi Gjykatën e Apelit si dhe palën e interesuar, përkatësisht, N.T.N “Nita Commerc” me seli në Komunën

e Malishevës (në tekstin e mëtejmë: "Nita Commerc") për regjistrimin e kërkesës. Kësaj të fundit, Gjykata i dha mundësinë për të komentuar në kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi edhe Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.

11. Më 7 shkurt 2020, "Nita Commerc" i dorëzoi në Gjykatë komentet përkatëse lidhur me rastin.

12. Më 9 shkurt 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të informojë Gjykatën se në cilën fazë është shqyrtimi i rastit të parashtruesit të kërkesës para Gjykatës Themelore.

13. Më 12 shkurt 2020, Gjykata Themelore e dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.

14. Më 16 shkurt 2021, Gjykata Themelore njoftoi Gjykatën se përkitazi me rastin kishte vendosur përmes Aktgjykimit [I.Ek.nr.330/2019] të 30 qershorit 2020 dhe se shqyrtimi i të njëjtit është në Gjykatën e Apelit sipas ankesës së "Nita Commerc". Gjykata Themelore në përgjigjen e saj theksoi se për më tepër informata, Gjykata duhet t'i drejtohet Gjykatës së Apelit.

15. Më 22 shkurt 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Apelit që të informojë Gjykatën se në cilën fazë është shqyrtimi i rastit si dhe të dorëzojë në Gjykatë Aktgjykimin [I.Ek.nr.330/19] e 30 qershorit 2020 të Gjykatës Themelore.

16. Më 24 shkurt 2021, Gjykata e Apelit e dorëzoi përgjigjen në Gjykatë, përmes të cilës njoftoi se lënda është në pritje për shqyrtim para Gjykatës së Apelit dhe është e evidentuar me shenjën [Ae.146/2020]. Në vijim, në lidhje me kërkesën specifike të Gjykatës për të dorëzuar Aktgjykimin [I.Ek.nr.330/19] e 30 qershorit 2020 të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit specifikoi se ky Aktgjykim është i bashkëlidhur në këtë përgjigje. Megjithatë, në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga Gjykata e Apelit, Aktgjykimi i lartcekur [I.Ek.nr.330/19] i 30 qershorit 2020 i Gjykatës Themelore nuk rezultoi të jetë i bashkëlidhur në përgjigjen e saj.

17. Më 24 shkurt 2021, Gjykata përmes postës elektronike kërkoi nga Gjykata e Apelit që të dorëzojë në Gjykatë Aktgjykimin [I.Ek.nr.330/19] e 30 qershorit 2020 të Gjykatës Themelore.

18. Më 26 shkurt 2021, Gjykata e Apelit përmes postës elektronike e dorëzoi në Gjykatë Aktgjykimin e lartcekur, përkatësisht Aktgjykimin [I.Ek.nr.330/19] e 30 qershorit 2020 të Gjykatës Themelore.

19. Më 12 prill 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe vendosi që vendimmarrjen për këtë rast ta shtyjë për një seancë tjetër.

20. Më 5 maj 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

21. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri konstatoi se (i) kërkesa është e pranueshme; dhe konstatoi se (ii) Aktvendimi [Ae.nr.287/18] i 27 majit 2019 i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi [I.EK.nr.330/19] i 1 gushtit 2019 i Gjykatës Themelore nuk janë në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

22. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës dhe "Nita Commerc", kanë qenë palë ndërgjygjëse në tri procedura kontestimore të cilat Gjykata do t'i paraqesë në vijim.

(i) Procedura e parë kontestimore lidhur me vërtetimin e borxhit, procedura e dytë kontestimore dhe procedura përmbarimore

23. Më 2 korrik 2003, parashtruesi i kërkesës dhe "Nita Commerc", kishin lidhur Kontratën për Kredi [nr.2/5 LI 582] (në tekstin e mëtejmë: Kontrata për Kredinë), në vlerë prej 269.800 euro, me kamatë vjetore prej katërmbëdhjetë përqind (14%), me detyrimin e kthimit të kredisë në afat prej dymbëdhjetë (12) muajsh. Bazuar në shkresat e lëndës, qëllimi i kredisë ishte "*pagesa e doganës dhe e pagesave tjera*" të përcaktuara përmes Kontratës së lartpërmendur.

24. Në të njëjtën datë, për të siguruar detyrimet që rrjedhin nga Kontrata për Kredi, palët gjithashtu nënshkruan Marrëveshjen mbi Kolateralin [nr. 336/02] (në tekstin e mëtejmë: Marrëveshja mbi Kolaterialin), bazuar në të cilën, "Nita Commerc" kishte lënë në hipotekë pasurinë e paluajtshme të evidentuar në Kontratën e lartcekur, në vlerën prej 597.000 euro.

25. Më 14 korrik 2006, për shkak të mospagesës së plotë të borxhit të kredisë, Banka kishte ngritur padi kundër "Nita Commerc" në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Ekonomike e Qarkut), për pjesën e mbetur të borxhit, respektivisht (i) borxhit në vlerë prej 150,000 euro; dhe (ii) kamatës së kontraktuar në vlerë prej 1,993.73 euro si dhe nga ajo datë e deri në pagesën definitive, kamatën vjetore të kontraktuar me vlerë katërmbëdhjetë përqind (14%) mbi bazën e borxhit kryesor. Banka gjithashtu kishte ngritur padi ndaj kompanive N.T.N "Mazreku" dhe N.T.T "Global Petrol" nga Komuna e Malishevës, në cilësinë e garantuesve të kredisë përkatëse të "Nita Commerc".

26. Më 30 tetor 2006, Gjykatës Ekonomike të Qarkut i ishte dorëzuar ekspertiza financiare e përgatitur nga eksperti Sh.M., bazuar në të cilën, ishte konstatuar se borxhi i "Nita Commerc" ndaj Bankës arrinte vlerën prej 199,230 euro.

27. Më 23 nëntor 2006, parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Banka, iu drejtua Gjykatës Ekonomike të Qarkut me kërkesën për tërheqjen e padisë ndaj kompanive N.T.N " Mazreku" dhe N.T.T "Global Petrol", respektivisht.

28. Më 23 nëntor 2006, Gjykata Ekonomike e Qarkut, përmes Aktgjykimit [VIII.C.Nr.207/06] e kishte aprovuar kërkesëpadinë e Bankës. Përmes këtij Aktgjykimi, gjykata e lartcekur, ndër të tjera, kishte përcaktuar se detyrohet e paditura, përkatësisht "Nita Commerc" që të paguajë (i) borxhin kryesor në emër të kredisë në vlerë prej 150,000 euro; (ii) kamatën e kontraktuar në vlerë prej 1,993.73 euro deri më 28 korrik 2006, ndërsa prej të njëjtës datë deri në pagesën definitive, kamatën e kontraktuar në borxhin kryesor në lartësi prej katërmbëdhjetë përqind (14%) në vit; si dhe (iii) shpenzimet e procedurës kontestimore në vlerë prej 1,500 euro. Aktgjykimi i lartcekur gjithashtu kishte theksuar, ndër të tjera, se (i) pretendimet e "Nita Commerc" se shumën prej 74,343.00 euro e ka paguar dy herë për shkak të "*ndërhyrjes së paautorizuar në llogarinë e tij*" të punëtoreve të Bankës, bazuar në dëshmitë para gjykatës dhe ekspertizën financiare të 30 tetorit 2006, nuk janë të bazuara, dhe se bazuar në këtë ekspertizë është konstatuar se *"nuk bëhet fjalë për pagesa të dyfishta por për një pagesë të bërë në kontinunitet"*; dhe (ii) kërkesëpadia ndaj palëve të tjera, përkatësisht, N.T.N "Mazreku" dhe N.T.T "Global Petrol", konsiderohet e tërhequr.

29. Në një datë të pasaktësuar, "Nita Commerc" paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës

Ekonomike të Qarkut, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

30. Më 17 shtator 2009, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Ae.nr.2/2007] e refuzoi si të pabazuar ankesën e "Nita Commerc" dhe vërtetoi Aktgjykimin [VIII.C.Nr.207/06] e 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut.

31. Më 30 tetor 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti propozim për përmbarim në bazë të Marrëveshjes mbi Kolateralin kundër "Nita Commerc". Më 11 nëntor 2009, Gjykata Komunale në Malishevë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale), përmes Aktvendimit [E.nr.406/09], e kishte lejuar përmbarimin.

32. Në një datë të pasaktësuar, "Nita Commerc" paraqiti edhe revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 të Gjykatës Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

33. Më 31 dhjetor 2009, "Nita Commerc" gjithashtu parashtroi padi të re në Gjykatën Ekonomike të Qarkut, kundër parashtruesit të kërkesës lidhur me pagesën e borxhit në vlerë prej 74.360 euro "*për shkak të fitimit të pa bazë*", duke u referuar në nenin 210 (Fitimi pa bazë) të Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore të vitit 1978 (në tekstin e mëtejmë: LMD e vjetër). Në anën tjetër, parashtruesi i kërkesës përmes përgjigjes në padi kishte deklaruar se kjo çështje paraqet "*çështje të gjykuar",* bazuar në Aktgjykimin e po të njëjtës gjykatë, përkatësisht Aktgjykimin [VIII.C.Nr.207/06] e 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, e të vërtetuar në ndërkohë edhe përmes Aktgjykimit [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 të Gjykatës Supreme.

34. Më 17 mars 2010, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. E.nr.20/2009] refuzoi si të pabazuar revizionin e "Nita Commerc" dhe vërtetoi Aktgjykimin [Ae.nr.2/2007] e 17 shtatorit 2009 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [VIII.C.Nr.207/06] e 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut.

35. Më 12 maj 2010, Gjykata Ekonomike e Qarkut, duke vepruar sipas padisë së 31 dhjetorit 2009 të "Nita Commerc", përmes Aktvendimit [IV.C.nr.1/2010] hodhi poshtë të njëjtën, duke u bazuar në nenet 391 [pa titull] dhe 393 [pa titull] të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK). I pari, përkatësisht neni

391, në pikën d) të tij, përcakton që padia hedhet poshtë si e palejueshme kur çështja paraqet "*çështje të gjykuar*". Gjykata Ekonomike e Qarkut në këtë Aktgjykim, ndër tjerash, gjithashtu kishte arsyetuar se përmes Aktgjykimit [C.nr.207/2006] të 23 nëntorit 2006, kishte shqyrtuar edhe pretendimin e "Nita Commerc" lidhur me "*pagesën e bërë dy herë në vlerë prej 74.360 euro*", duke refuzuar të njëjtin si të pabazuar, konstatim ky që ishte vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme përmes dy Aktgjykimeve të saj, Aktgjykimit [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 dhe Aktgjykimit [Rev.E.nr.20/2009] të 17 marsit 2010, respektivisht.

36. Më 26 korrik 2013, duke u bazuar në Aktvendimin [E.nr.406/09] të 11 nëntorit 2009 të Gjykatës Komunale përmes të cilit ishte lejuar përmbarimi bazuar në Aktgjykimin [VIII.C.Nr.207/06] e 23 nëntorit 2006 të Gjykata Ekonomike e Qarkut e të vërtetuar më pas nga Gjykata Supreme përmes dy Aktgjykimeve të lartcekura të saj, kishte përfunduar ekzekutimi i procedurës përmbarimore lidhur me hipotekën që ishte lënë peng për sigurimin e kredisë nga "Nita Commerc".

(ii) Procedura penale dhe procedura e tretë kontestimore

37. Në maj të vitit 2010, "Nita Commerc" kishte filluar edhe dy procedura të tjera. Fillimisht, më 17 maj 2010, "Nita Commerc" kishte ushtruar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Prokuroria Themelore), kundër Drejtorit të Bankës, përkatësisht I.Z., dhe punëtoreve të Bankës, A.Sh., M.B., dhe Sh.K., respektivisht, duke pretenduar se nga xhirollogaria e "Nita Commerc", pa autorizim kanë tërhequr shumën prej 79,786,00 euro, dhe "*të cilën nuk e kanë evidentuar por e kanë ndalur për vete*". Ndërsa, më 19 maj 2010, "Nita-Commerc", gjithashtu kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale, duke kërkuar "*moslejimin e ekzekutimit*" të Aktvendimit [E.nr.406/09] të 11 nëntorit 2009 të Gjykatës Komunale dhe i cili kishte lejuar përmbarimin lidhur me procedurën e parë kontestimore, duke përsëritur pretendimet e paraqitura në kallëzimin penal dhe duke vënë theks në faktin se punëtoret përkatës të Bankës, përkatësisht A.Sh., M.B., dhe Sh.K., "*kanë tërhequr në mënyrë të palejueshme shumën prej 74,000 euro nga llogaria e tij*". Në anën tjetër, parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Banka, përmes përgjigjes në padi, kontestoi padinë si të pabazuar, duke përsëritur faktin se çështjet e ngritura nga "Nita Commerc", përbëjnë "*çështje të gjykuar*", sepse ishte shqyrtuar dhe vendosur tashmë përmes vendimeve përfundimtare të gjykatave të rregullta.

38. Më 4 qershor 2013, bazuar në kallëzimin e lartcekur penal, Departamenti për Krime të Rënda i Prokurorisë Themelore, përmes Aktvendimit për fillimin e hetimeve, përkatësisht Aktvendimit [PP.567/2013], kishte konstatuar se ndaj të pandehurve A.Sh., M.B. dhe Sh.K., respektivisht, duhet të fillojnë hetimet, pasi që "*ekziston dyshimi i arsyeshëm se të njëjtit kanë kryer vepër penale*" të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 340 (Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës) në lidhje me paragrafin 1 të nenit 23 (Bashkëkryerja) të Kodit nr.2003/25 të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK).

39. Ndërsa, më 13 shtator 2013, "Nita Commerc" kishte paraqitur një parashtresë në Degën e Malishevës të Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke kërkuar ndryshimin e kërkesëpadisë së 19 majit 2010. Kjo e fundit, siç është sqaruar më lart, fillimisht ishte dorëzuar si padi për "*moslejimin e ekzekutimit*", ndërsa "Nita Commerc" kërkoi që e njëjta të ndryshohet në padi për kompensim dëmi bazuar në nenin 259 [pa titull] të LPK-së. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se kompensimi i dëmit të cilën e kërkoi "Nita Commerc" është në vlerën e 98,019.43 euro.

40. Më 20 qershor 2014, Dega në Malishevë e Gjykatës Themelore në Gjakovë përmes Aktvendimit [C.nr.62/10] ishte shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur lidhur me këtë çështje dhe lëndën ia kishte referuar Gjykatës Themelore në Prishtinë.

41. Më 14 korrik 2015, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit që është pjesë e procesverbalit nga seanca e shqyrtimit kryesor, kishte vendosur që të ndërprehet procedura kontestimore lidhur me këtë çështje, deri sa të vendoset lënda penale [PP.I.567/13].

42. Më 5 dhjetor 2015, Prokuroria Themelore në Ferizaj, ngriti Aktakuzën [PP.l.nr. 111/20 J 5], ndaj të akuzuarve A.Sh. dhe M.B., nën dyshimin e bazuar se kanë kryer veprën penale "*përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës"* të përcaktuar përmes paragrafit 3 të nenit 340 lidhur me paragrafin 1 të nenint 23 të KPPK-së. Bazuar në shkresat e lëndës, në shqyrtimet e mbajtura gjatë muajit shkurt dhe mars të vitit 2016, Prokurori i Shtetit, kishte bërë ndryshimin e Aktakuzës, duke u tërhequr nga Aktakuza ndaj të akuzuarit M.B.

43. Më 31 mars 2016, Departamenti për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore, përmes Aktgjykimit [PKR.nr.209/2015] kishte liruar nga akuza edhe personin A.Sh., ndërsa për realizimin e kërkesës pasurore juridike "Nita Commerc" e kishte udhëzuar në kontest civil. Bazuar në

shkresat e lëndës, ky Aktgjykim ishte konfirmuar përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.392/16] të 15 marsit 2017 të Gjykatës së Apelit.

44. Më 14 shtator 2016, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit, që është pjesë e procesverbalit nga seanca e shqyrtimit kryesor, vendosi që të vazhdohet procedura kontestimore e ndërprerë përmes Aktvendimit të 14 korrikut 2015.

45. Më 17 tetor 2016, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [I.C.nr.424/2014], caktoi ekspertin F.K., për të punuar ekspertizën financiare për të vlerësuar nëse ka pasur ndërhyrje të paautorizuar nga ana e Bankës në xhirollogarinë e "Nita Commerc", në vlerën prej (i) 74,089.37 euro; dhe (ii) 23,930.06 euro si "*mjete të papërfshira në pasqyrat e llogarisë*", dhe rrjedhimisht në vlerën e përgjithshme prej 98,019.93 euro. Ndërsa, më 18 janar 2018, Banka kërkoi që padia e "Nita Commerc" të hedhet poshtë si e palejuar, duke pretenduar sërish se në këtë rast kemi të bëjmë me "*çështje të gjykuar*".

46. Më 24 nëntor 2016, në Gjykatën Themelore ishte dorëzuar ekspertiza financiare e punuar nga F.K., e cila kishte konstatuar, ndër të tjera, se (i) "*pagesat e kryera në emër të detyrimeve doganore (8 veprime në vlerë prej 74,306 euro) nuk kanë sjellë ndonjë dëm për kompaninë "Nita Commerc" dhe nuk ka pasur ndonjë dyfishim të veprimeve bankare*"; dhe (ii) përkitazi me pretendimin tjetër të palës se është dëmtuar në vlerë 23,930.06 euro, "*vlera prej 1,610 euro ka të bëjë me provizionet në emër të kredive të lejuara, ndërsa vlera prej 1,455 fillimisht është regjistruar në dëm të klientit mirëpo më vonë banka ka kryer stronimet e duhura*", ndërsa "*vlera e mbetur prej 20,837.90 euro paraqet obligimet kreditore të klientit ndaj bankës dhe për këtë gjykata ka marr vendim*".

47. Më 26 janar 2017, bazuar në procesverbalin e Gjykatës Themelore, kjo e fundit, përmes Aktvendimit [I.C.nr.424/2014], e kishte miratuar propozimin për nxjerrjen edhe të një ekspertize, nga një grup i përbërë prej tre ekspertëve të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: Fakulteti Ekonomik) në lidhje me vlerën kontestuese prej 74,000 euro. Megjithatë, duke marrë parasysh që ekspertiza përkatëse nuk ishte dorëzuar, më 26 mars 2018, Gjykata Themelore përmes Policisë së Kosovës urdhëroi Fakultetin Ekonomik që të kthejë dosjen e lëndës përkatëse. Lënda përkatëse, për pasojë, i është dorëzuar Gjykatës Themelore, por jo edhe ekspertiza financiare, e cila sipas arsyetimit të Fakultetit Ekonomik nuk ka mundur të punohet për shkak se "*palët nuk janë përgjigjur në dorëzimin e provave*". Marrë parasysh këtë, më 11 prill 2018, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [I.EK.nr.424/14] u shqiptoi dënim me gjobë

grupit të tre ekspertëve të Fakultetit Ekonomik sepse (i) grupi përkatës ka mbajtur dosjen origjinale të rastit për më shumë se një (1) vit përkundër faktit që gjykata përkatëse e ka caktuar afatin prej tridhjetë (30) ditësh për dorëzimin e raportit të ekspertizës; për më tepër që (ii) grupi përkatës nuk ka dorëzuar fare raportin e ekspertizës.

48. Më 2 nëntor 2018, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [I.E.K.nr.424/14] hodhi poshtë padinë e "Nita Commerc". Në këtë Aktvendim, ndër të tjera, theksohet se pavarësisht lartësisë së vlerës që pretendohet me padi të re, (i) objekti i kërkesëpadisë është i njëjtë; (ii) pretendimet për shumën e kërkuar mbështeten në të njëjtat fakte dhe mbi të njëjtën bazë; dhe (iii) palët në proces gjyqësor janë të njëjta, prandaj Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit të lartcekur, konstatoi se kërkesa i plotëson kushtet për t'u konsideruar si "*çështje e gjykuar*", bazuar në nenin 391 të LPK-së.

49. Më 22 nëntor 2018, kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, "Nita Commerc" kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në anën tjetër, parashtruesi i kërkesës përmes përgjigjes në ankesë kishte propozuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe çështja të trajtohet si "*çështje e gjykuar*".

50. Më 27 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ae.nr.287/18], e aprovoi si të bazuar ankesën e "Nita Commerc", duke e anuluar Aktvendimin [I.EK.nr.424/14] e 2 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore dhe lëndën e ktheu në shkallë të parë në rivendosje. Gjykata e Apelit, në arsyetimin e këtij konstatimi, kishte theksuar se Aktvendimi i atakuar është nxjerrë në shkelje të paragrafit 1 të nenit 182 [pa titull] në lidhje me pikën d) të paragrafit 1 të nenit 391 të LPK-së, sepse (i) pozita e palëve në procedurë është e ndryshme, sikur që është e ndryshme edhe baza juridike si dhe vlera e kontestit; dhe (ii) është gjykuar çështja e pagimit të borxhit, ndërsa tani objekt kontesti është kompensimi i dëmit që "*pretendohet se e paditura përkatësisht zyrtarët e saj i kanë shkaktuar dëme paditësit duke përvetësuar të holla nga gjiro-llogarija e saj, në mënyrë të kundërligjshme dhe kundër të cilëve kanë filluar hetimet penale*".

51. Në një datë të pasaktësuar, kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar një shkresë në Gjykatën Themelore, duke kërkuar që të hedhet poshtë padia e "Nita Commerc", pasi që kjo çështje kontestimore paraqet "*çështje të gjykuar*".

52. Më 1 gusht 2019, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [I.EK.nr.330/19] refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës që çështja kontestuese të konsiderohet si "*çështje e gjykuar*" dhe vendosi që bazuar në rekomandimet e dhëna përmes Aktvendimit [Ae.nr.287/18] të 27 majit 2019 të Gjykatës së Apelit, procedura të vazhdojë me shqyrtim meritor të kërkesëpadisë. Kundër këtij Aktvendimi nuk u lejua ankesa.

53. Më 23 shtator 2019, duke u referuar në pikën b) të paragrafit 1 të nenit 245 [pa titull] të LPK-së, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Zyrës së Prokurorit të Shtetit me propozimin për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit [Ae.nr.287/18] të 27 majit 2019 të Gjykatës së Apelit.

54. Më 3 tetor 2019, Zyra e Prokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit [KMLC.nr.158/2019] njoftoi parashtruesin e kërkesës se kërkesa e tij nuk është aprovuar, sepse nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore bazuar në pikat a) dhe b) të paragrafit 1 të nenit 247 [pa titull] të LPK-së.

(iii) Procedura pasi parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimeve të kontestuara

55. Më 23 tetor 2019, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [I.EK nr.424/2014] caktoi edhe një super-ekspertizë financiare lidhur me kontestin në mes palëve, përkatësisht vlerën e kontestuar prej 74,000 euro, duke i caktuar tre ekspertë financiarë, përkatësisht R.A., A.Z. dhe M.M., për përgatitjen e super-ekspertizës.

56. Më 14 nëntor 2019, ekspertët e lartcekur financiar, dorëzuan në Gjykatën Themelore "*super ekspertizën financiare*", e cila ndër tjerash, kishte konstatuar se (i) subjektit "Nita Commerc" nuk i është shkaktuar dëm; (ii) "*nuk ka pasur ndërhyrje të punëtorëve të bankës në llogarinë e subjektit Nita Commerc" pa autorizim, por se të gjitha tërheqjet dhe pagesat e obligimit të klientit të tyre ndaj Doganave të Kosovës janë kryer konform nenit 4 të Kredisë suzaore me nr 2/5-582 nga dt.02.07.2003* [...]"; dhe (iii) nuk rezulton të ketë pasur pagesa të dyfishta.

57. Më 30 qershor 2020, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [I.EK.nr.330/19] refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e "Nita Commerc". Gjykata Themelore në arsyetimin e saj, ndër të tjera, theksoi se bazuar në nenin 154 (Bazat e Përgjegjësisë) së LMD-së së vjetër është e përcaktuar se kushdo që i shkakton dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensojë, nëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij

dhe në rastin konkret, asnjëra nga pretendimet e "Nita Commerc" lidhur me pretendimin se "*e paditura ka keqpërdorur mjetet e paditësit nga llogaria e tij duke tërhequr mjetet nga llogaria e tij pa autorizim*", nuk është dëshmuar para Gjykatës Themelore.

58. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, "Nita Commerc" ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit. Bazuar në përgjigjen e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit dorëzuar në Gjykatë, në datat 16 shkurt 2021 dhe 24 shkurt 2021, respektivisht, ankesa e lartcekur e "Nita Commerc", është në pritje të shqyrtimit para Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

59. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktvendimet e kontestuara, përkatësisht Aktvendimi [Ae.nr.287/18] i 27 majit 2019 i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi [I.EK.nr. 330/19] i 1 gushtit 2019 i Gjykatës Themelore, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimet e lartcekura duke pretenduar shkelje të neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, për shkak të (i) cenimit të parimit të sigurisë juridike; dhe (ii) mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

(i) Sa i përket pretendimeve për cenim të parimit të sigurisë juridike

60. Parashtruesi i kërkesës, në këtë kontekst, pretendon se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit të kontestuar ka rihapur një vendim të formës së prerë, përkatësisht Aktgjykimin [VIII.C.Nr.207/06] e 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, në kundërshtim me garancitë kushtetuese të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës thekson se parimi i sigurisë juridike është një ndër aspektet kryesore të sundimit të ligjit, i cili, ndër tjerash, presupozon respektimin e parimit *res judicata*, e që është parimi i formës së prerë të vendimeve gjyqësore. Në kontekst të shkeljes së këtij parimi, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, thekson se (i) përkundër Aktgjykimit [VIII.C.Nr.207/06] të 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut; dy Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, Aktgjykimit [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 dhe Aktgjykimit [Rev E.nr.20/2009] të 17 marsit 2010, respektivisht; Aktvendimit [IV.C.nr.1/2010] të 12 majit 2010 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut; dhe Aktvendimit [I.EK.nr.424/14] të 2 nëntorit 2018 të

Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit dhe më pas Gjykata Themelore, përmes Aktvendimeve të kontestuara, më shumë se (9) vite më vonë, kanë rihapur një proces gjyqësor, duke e vlerësuar se i njëjti nuk paraqet "*çështje të gjykuar*"; (ii) ankesa para Gjykatës së Apelit, mbi bazën e të cilës, e njëjta e ka rihapur një proces gjyqësor i cili paraprakisht ishte cilësuar nga vetë gjykatat e rregullta si *res judicata*, ndërlidhet me të njëjtën çështje, të njëjtën gjendje faktike, të njëjtat palë dhe të njëjtin raport juridik i cili tashmë, ishte vendosur nga gjykatat e rregullta; (iii) pretendimi i "Nita Commerc", mbi bazën e të cilit i njëjti ka ngritur padi të re dhe mbi bazën e të cilit Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit të kontestuar ka rihapur një "*çështje të gjykuar*", është shqyrtuar që në fillim të këtij procesi gjyqësor, përkatësisht në vitin 2006, duke u hedhur poshtë nga Gjykata Ekonomike e Qarkut, përmes Aktgjykimit [VIII.C.Nr.207/06] të 23 nëntorit 2006, si të pabazuar, konstatim ky i cili më pas ishte konfirmuar edhe dy herë nga Gjykata Supreme; (iv) në hapjen e një rasti *res judicata*, Gjykata e Apelit, është gjithashtu në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, të reflektuar në vëllimin e tretë të Buletinit të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Supreme të vitit 2016, sipas të cilit, për tu konsideruar një çështje *res judicata*, duhet të ekzistojë identiteti, përkatësisht njëjtësia subjektive e palëve, të ekzistojë identiteti i kërkesës, të ekzistojë identiteti i gjendjes faktike dhe kontesti të jetë zhvilluar dhe përfunduar në procedurë kontestimore, kushte këto të cilat janë të plotësuara në rrethanat e rastit konkret; dhe (v) në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, një vendim gjyqësor dhe i plotfuqishëm, përkatësisht Aktgjykimi [VIII.C.Nr.207/06] i 23 nëntorit 2006 i Gjykatës Ekonomike të Qarkut, ka mbetur pa efekt, në dëm të parashtruesit të kërkesës, duke rezultuar kështu në të drejta kushtetuese "*iluzore*" për të njëjtin.

61. Në mbështetje të pretendimeve të tij për cenimin e sigurisë juridike, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të (i) Gjykatës në rastet si në vijim: KI08/09, parashtrues, *Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës së tubave të çelikut - IMK nga Ferizaj,* Aktgjykim i 17 dhjetorit 2010 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI08/09); KI132/15, parashtrues *Manastiri i Deçanit*, Aktgjykimi i 20 majit 2016 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI132/15); KI122/17, parashtrues *Česká Exportni Banka* A.S, Aktgjykim i 18 prillit 2018 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI122/17); KI87/18, parashtrues *Kompania e Sigurimeve "IF Skadeforsikring",* Aktgjykim i 27 shkurtit 2019 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI87/18); dhe (ii) Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) në rastin *Ponomaryov kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 3 prillit 2008.

(ii) Sa i përket pretendimeve për mungesë të arsyetimit të vendimit gjyqësor

62. Parashtruesi i kërkesës, në këtë kontekst, pretendon se Gjykata Themelore dhe ajo Apelit, respektivisht, përmes Aktvendimeve të kontestuara, kanë dështuar të arsyetojnë vendimmarrjen e tyre dhe të adresojnë e arsyetojnë pretendime thelbësore të parashtruesit të kërkesës, në kundërshtim me garancitë kushtetuese të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës, duke u referuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës në kontekst të vendimit të arsyetuar gjyqësor, thekson se gjykatat e rregullta janë të detyruara që të adresojnë pretendimet thelbësore të palëve përkatëse dhe të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat e kanë bazuar vendimmarrjen e tyre, ndërsa do të veprojnë në kundërshtim me garancitë kushtetuese për një vendim të arsyetuar gjyqësor, nëse nuk ofrojnë asnjë përgjigje përkitazi me pretendimet thelbësore të palëve.

63. Parashtruesi i kërkesës më specifikisht thekson se (i) Aktvendimi [Ae.nr.287/18] i 27 majit 2019 i Gjykatës së Apelit, nuk përmban asnjë referencë apo arsyetim lidhur me pretendimet e tij se përmes Aktvendimit [IV.C.nr.1/2010] të 12 majit 2010 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, padia e "Nita Commerc" është hedhur poshtë si *res judicata*; ndërsa (ii) Aktvendimi [I.EK.nr.330/19] i 1 gushtit 2019 i Gjykatës Themelore, gjithashtu nuk ka adresuar asnjërin nga pretendimet e tij, por për rihapjen e një procedure kontestimore në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe ato të KEDNJ-së përkitazi me parimin e sigurisë juridike, është mjaftuar me konstatimin se "*kështu ka përcaktuar Gjykata e Apelit*".

64. Në mbështetje të pretendimeve të tij për shkeljen e të drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës, në rastet si në vijim: KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu,* Aktgjykim i 27 majit 2019 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI24/17); KI138/15, parashtrues "*Sharr Beteiligungs GmbH" SH.P.K.*, Aktgjykim i 4 shtatorit 2017 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI138/15); KI72/12, parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykim i 5 dhjetorit 2012 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI72/12); dhe rastin e Gjykatës KI122/17.

65. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të (i) deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) konstatojë se Aktvendimi [Ae.nr. 287/18] i 27 majit 2019 i Gjykatës së Apelit dhe

Aktvendimi [I.EK.nr.330/19] i 1 gushtit 2019 i Gjykatës Themelore janë të pavlefshme; dhe (iv) kthejë Aktvendimin [Ae.nr. 287/18] e 27 majit 2019 të Gjykatës së Apelit në rivendosje pranë Gjykatës së Apelit "*në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese*".

Komentet e "Nita Commerc"

66. Përmes përgjigjes në Gjykatë të dorëzuar më 7 shkurt 2020, "Nita Commerc" i kundërshtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Fillimisht, "Nita Commerc", theksoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Në këtë kontekst, e njëjta theksoi se "*edhe pse me Aktvendimin e Gjykatës Themelore-Departamenti i Cështjeve Ekonomike I.EK.nr.330/19 të datës 1 gusht 2020 nuk është lejuar ankesë e posaçme kundër këtij aktvendimi, parashtruesi i kërkesës ka të drejtën që për të njëjten çeshtje ta godet me ankesë kunder vendimit me të cilin përfundon procedimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë, pasi që lidhur me rastin konkret procedura kontestimore nuk ka perfunduar në shkallë të parë pranë gjykatës kompetente, kjo vërtetohet edhe nga pika e 2 i dispozitivit te këtij Aktvendimit[...]*".

67. Ndërsa përkitazi me meritat e rastit, "Nita-Commerc" (i) i referohet Aktgjykimit [PKR.nr.209/2015] të 31 marsit 2016 të Gjykatës Themelore përmes së cilit, e njëjta për realizimin e kërkesës pasurore ishte udhëzuar në kontest civil; dhe (ii) thekson se Gjykata e Apelit me të drejtë ka konstatuar se nuk kemi të bëjmë me "*çështje të gjykuar*", sepse "*në rastin konkret pozita e palëve në procedurë është e ndryshme (ku në këtë rast jemi si palë paditëse) si dhe vlera e kontestit është e ndryshme nga ajo e Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë VIII.C.nr.207/06 e datës 23.11.2006*".

Vlerësimi i pranueshmërisë kërkesës

68. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

69. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

70. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

71. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI118/18, parashtrues, *Eco Construction sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 tetorit 2019, paragrafi 29 dhe referencat e përdorura aty).

72. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 47 (Kërkesa Individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

1.Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]."

73. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke i kontestuar dy akte të autoritetit publik, përkatësisht (i) Aktvendimin [Ae.nr.287/18] e 27 majit 2019 të Gjykatës së Apelit; dhe (ii) Aktvendimin [I.EK.nr. 330/19] e 1 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore. Përkitazi me të dy Aktvendimet e kontestuara, parashtruesi i kërkesës i ka qartësuar saktësisht të drejtat dhe liritë themelore që pretendon si i janë cenuar, siç është përcaktuar në nenin 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën e tij brenda afateve të përcaktuara përmes nenit 49 të Ligjit.

74. Megjithatë, Gjykata duhet gjithashtu të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj, siç kërkohet përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Plotësimin e këtij kriteri, Gjykata do e vlerësoj veç e veç përkitazi me të dy aktet e kontestuara, duke filluar me Aktvendimin [Ae.nr.287/18] e 27 majit 2019 të Gjykatës së Apelit, për të vazhduar me Aktvendimin [I.EK.nr.330/19] e 1 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore.

75. Këtë vlerësim, Gjykata do e bëjë duke u bazuar në parimet e përgjithshme përkitazi me shterimin e mjeteve juridike, siç janë shtjelluar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës. Kjo e fundit, ka shtjelluar këto parime në mënyrë të detajuar në një numër rastesh, duke përshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI108/18, parashtrues *Blerta Morina*, Aktvendim për papranueshmeri i 30 shtatorit 2019; KI147/18, parashtrues *Artan Hadri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 tetorit 2019; KI211/19, parashtrues *Hashim Gashi, Selajdin Isufi, B.K., H.Z., M.H., R.S., R.E., S.O., S.H., H.I., N.S., S.I., dhe S.R,* Aktvendim për papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020; KI43/20, parashtruese *Fitore Sadikaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 gushtit 2020; dhe KI42/20, parashtrues *Armend Hamiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 gushtit 2020.

(i) Përkitazi me Aktvendimin [Ae.Nr.287/18] e 27 majit 2019 të Gjykatës së Apelit

76. Gjykata rikujton se Aktvendimi i lartcekur i Gjykatës së Apelit është nxjerrë bazuar në ankesën e "Nita Commerc" kundër Aktvendimit [I.EK.nr. 424/14] të 2 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore, dhe i cili e kishte hedhur poshtë padinë e të njëjtit mbi bazën e pikës d) të paragrafit 1 të nenit 391 të LPK-së, duke e kualifikuar këtë çështje si *res judicata*. Gjykata e Apelit, e kishte anuluar këtë Aktvendim të Gjykatës Themelore, duke vlerësuar se çështja para saj nuk mund të kualifikohej si *res judicata* dhe duke e kthyer çështjen në Gjykatën Themelore në rivendosje përkitazi me meritat e rastit. Kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit, por kjo e fundit përmes Njoftimit [KMLC.nr.158/2019] të 3 tetorit 2019, e kishte refuzuar të njëjtën.

77. Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, vendimet e Gjykatës së Apelit, mund të kontestohen para Gjykatës, dhe kjo e fundit, në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar se mjetet juridike janë shteruar nga parashtruesit e kërkesave përkatëse të cilët kanë kontestuar vendime të Gjykatës së Apelit. Këtë praktikë gjyqësore, Gjykata e ka ndërtuar bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas së cilës, ndër të tjera, parashtruesit e kërkesave përkatëse, jodetyrimisht kushtëzohen të përdorin edhe mjetet e jashtëzakonshme juridike. (Shih, Udhëzuesin për Kriteret e Pranueshmërisë të GJEDNJ-së të 30 prillit 2020; I. Kriteret procedurale për papranueshmëri; A. Mos-shterimi i mjeteve juridike; 2. Aplikimi i rregullit; e) Ekzistenca dhe përshtatshmëria, paragrafi 89 dhe referencat e përdorura aty). Për më tepër që, bazuar në po të njëjtën praktikë gjyqësorë, në rast të ekzistencës së më shumë së një mjeti juridik efektiv, është e mjaftueshme që një parashtrues të ketë përdorur njërin prej tyre. (Shih, Udhëzuesin për Kriteret e Pranueshmërisë të GJEDNJ-së të 30 prillit 2020; I. Kriteret procedurale për papranueshmëri; A. Mos-shterimi i mjeteve juridike, 2. Aplikimi i rregullit; c) Ekzistenca e disa mjeteve të ankimimit; paragrafi 86 dhe referencat e përdorura aty). Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, kundër Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit dhe e cila ishte refuzuar.

78. Për pasojë, bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar mjetet juridike përkitazi me Aktvendimin [Ae.Nr.287/18] e 27 majit 2019 të Gjykatës së Apelit, në

përputhshmëri me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Përkitazi me Aktvendimin [I.EK.nr.330/19] e 1 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore

79. Gjykata rikujton që Aktvendimi i lartcekur i Gjykatës Themelore është nxjerrë si pasojë e Aktvendimit [Ae.nr.287/18] të 27 majit 2019 të Gjykatës së Apelit. Aktvendimi i Gjykatës Themelore (i) në kështillën përkatëse juridike kishte theksuar se kundër këtij Aktvendimi "*nuk është e lejuar ankesa*"; dhe (ii) kishte rifilluar procedurën kontestimore në mes palëve përkatëse, përkatësisht parashtruesit të kërkesës dhe "Nita Commerc", duke arsyetuar se " *Gjykata e Apelit e Kosovës në procedurë ankimore, me aktvendimin Ae.nr.287/18 të datës 27.05.2019 e ka prishur Aktvendimin mbi hedhjen e padisë, I.EK.nr.424/14, të datës 2.11.2018, dhe e ka kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje, me arsyetimin se kërkesa nga padia nuk paraqet çështje të gjykuar dhe njëkohësisht i është rekomanduar kësaj gjykate që të zhvilloj gjykimin në shkallë të parë, respektivisht që të bëjë shqyrtimin meritor të kërkesëpadisë.* "Nita Commerc", në komentet e saj të dorëzuara në Gjykatë, specifikisht ka pretenduar mungesë të shterimit të mjeteve juridike përkitazi me Aktvendimin e Gjykatës Themelore.

80. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht i referohet nenit 206 [pa titull] të LPK-së, i cili, ndër tjerash, përcakton se po që se me të njëjtin ligj parashihet shprehimisht se ankimi i veçantë nuk lejohet, aktvendimi i shkallës së parë mund të goditet vetëm me anë të ankesës që paraqitet kundër vendimit me të cilin përfundon procedimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë. Bazuar në këtë dispozitë, edhe sipas pretendimit të "Nita Commerc", Aktvendimi [I.EK.nr.330/19] 1 gushtit 2019 i Gjykatës Themelore, do të mund të ankimohej në Gjykatën e Apelit, vetëm pasi të ketë përfunduar procedura në Gjykatën Themelore.

81. Megjithatë, në raste të tilla, e që ndërlidhen me pretendime për cenimin e sigurisë juridike, përkatësisht rihapjen e procedurave gjyqësore që mund të kenë arritur statusin e vendimeve *res judicata*, Gjykata, fillimisht rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila në raste të tilla, aplikon një qasje fleksibile në vlerësimin e shterimit të mjeteve juridike. Për shembull, dhe ndër të tjera, në rastin *Brumarescu kundër Romanisë* (Aktgjykim i 28 tetorit 1999), GJEDNJ kishte vlerësuar meritat e rastit përkundër faktit që çështja ishte në rishqyrtim e sipër në gjykatën përkatëse vendore, duke konstatuar

shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, si rezultat i rihapjes së procedurave gjyqësore dhe kthimit të tyre në rivendosje, pasi që çështja një fjalë ishte gjykuar një herë dhe kishte arritur statusin *res judicata*. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Brumarescu kundër Romanisë*, cituar më lart, paragrafin 30 dhe paragrafët 51 deri më 55).

82. Bazuar në këtë praktikë gjyqësore, Gjykata gjithashtu ka bërë përjashtime në kuptim të shterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj lidhur me raste në të cilat vendimet paraprake gjyqësore mund të kenë arritur statusin *res judicata*. Më saktësisht, në rastet (i) KI132/15, Gjykata konstatoi se parashtruesi përkatës ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj përkundër faktit që përmes një vendimi të Kolegjit të Apelit ishin anuluar Aktgjykimet paraprake dhe të cilat pretendohej të kenë arritur statusin e vendimeve *res judicata*, dhe çështja ishte kthyer në rivendosje në Gjykatën Themelore në Pejë (shih, rastin e Gjykatës KI132/15, cituar më lart, paragrafët 60 deri 66); dhe (ii) KI122/17, Gjykata konstatoi se parashtruesi përkatës ka shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj, përkundër faktit që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin përkatës të Gjykatës Themelore, ndër të tjera, kishin konstatuar se parashtruesi përkatës, "*nuk i ka shfrytëzuar te gjitha mjetet juridike administrative*", konstatim ky të cilin e kishte arritur vetëm pas mbajtjes së katër procedurave gjyqësore lidhur me një masë të sigurimit, e të cilat sipas pretendimeve përkatëse, kishin rihapur procedura të cilat tashmë kishin arritur statusin e vendimeve *res judicata*. (Shih, rastin e Gjykatës KI122/17, cituar më lart, paragrafi 122).

83. Për pasojë, bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka shteruar mjetet juridike përkitazi me Aktvendimin [I.EK.nr.330/19] e 1 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore, në përputhshmëri me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

84. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, neneve 47, 48 dhe 49 të Ligjit dhe paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Për më tepër, e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Ndërsa, Gjykata konsideron se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe për pasojë,

ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1.Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

Ligji Nr.03-L006 për Procedurën Kontestimore

Neni 182
[pa titull]

182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejt ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.

Neni 259
[pa titull]

Në qoftë se paditësi e ndryshon padinë, duke kërkuar nga e njëjta bazë faktike sendin tjetër apo një shumë të hollash, i padituri nuk mund ta kundërshtoj atë po që se ndryshimi është pasojë e rrethanave të krijuara pas ngritjes së padisë.

Neni 391
[pa titull]

Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se:

a) çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore;
b) palët kanë lidhë kontratë për zgjidhjen e kontestit të tyre nga arbitrazhi;
c) për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca);
d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata);

Meritat

85. Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një Kontratë për Kredi dhe Marrëveshjen pasuese për Kolateral të vitit 2003, bazuar në të cilat, "Nita Commerc" kishte marrë një kredi prej 269.800,00 euro nga Banka, me afat kthimi prej dymbëdhjetë (12) muajsh. Duke marrë parasysh që detyrimet e "Nita Commerc" ndaj Bankës nuk ishin kryer bazuar në marrëveshjen në mes palëve, që nga viti 2006 kishin filluar procedurat gjyqësore e të cilat kanë rezultuar në një procedurë penale dhe tri procedura kontestimore.

86. Që në fillim të procedurave gjyqësore, Banka kishte pretenduar se "Nita Commerc" nuk i ka kryer detyrimet ndaj Bankës, duke kërkuar

që të vërtetohet borxhi në vlerë prej 150,000 euro dhe kamata përkatëse, ndërsa "Nita Commerc" kishte kundërshtuar këto pretendime, duke theksuar, ndër tjerash, gjithashtu, se punëtorët e Bankës kishin realizuar ndërhyrje të paautorizuara në llogarinë e saj bankare, duke rezultuar në pagesa të dyfishta në shumën prej 74,000 euro. Vendimi i parë në proceset gjyqësore që kishin pasuar si rezultat i këtij kontesti, është Aktgjykimi [VIII.C.Nr.207/06] i 23 nëntorit 2006 i Gjykatës Ekonomike të Qarkut, përmes së cilit, e njëjta, pasi kishte shqyrtuar ekspertizën e 30 tetorit 2006, kishte miratuar kërkesëpadinë e Bankës, duke e detyruar "Nita Commerc", që të paguajë borxhin kryesorë prej 150,000 euro dhe kamatën përkatëse, dhe duke theksuar, ndër të tjera, se pretendimet e "Nita Commerc" se shumën prej 74,343.00 euro e ka paguar dy herë për shkak të "*ndërhyrjes së paautorizuar në llogarinë e tij*" të punëtorëve të Bankës, bazuar në dëshmitë para gjykatës dhe ekspertizën financiare të 30 tetorit 2006, nuk janë të bazuara, dhe se bazuar në po këtë ekspertizë, është konstatuar se *"nuk bëhet fjalë për pagesa të dyfishta por për një pagesë të bërë në kontinunitet"*.

87. Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut, ishte konfirmuar dy herë përmes Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimeve [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 dhe [Rev.E.nr.20/2009] të 17 marsit 2010, respektivisht. Procedurat përkitazi me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, gjithashtu kishin marrë miratimin e gjykatave të rregullta, përmes Aktvendimit [E.nr.406/09] të 11 nëntorit 2009 të Gjykatës Komunale. Bazuar në shkresat e lëndës, ekzekutimi i procedurës përmbarimore lidhur me hipotekën që ishte lënë peng për sigurimin e kredisë nga "Nita Commerc", kishte përfunduar më 26 korrik 2013.

88. Megjithatë, në dhjetor të vitit 2009, "Nita Commerc" filloi procedurat e reja gjyqësore kundër Bankës. Kësaj radhe, "Nita Commerc", kishte ngritur padi kundër Bankës, përkitazi me vlerën prej 74.360.00 eurosh, të cilën kishte pretenduar se Banka e kishte përvetësuar si rezultat i ndërhyrjes së paautorizuar të punëtorëve të saj në llogarinë e saj bankare. Gjykata Ekonomike e Qarkut përmes Aktvendimit [IV.C.nr.1/2010] të 12 majit 2010 e kishte hedhur poshtë padinë bazuar në nenin 391 të LPK-së, duke e vlerësuar të njëjtën si *res judicata*, duke u referuar në tri vendime paraprake gjyqësore, përkatësisht Aktgjykimin [C.nr. 207/2006] e 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut dhe Aktgjykimeve [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 e [Rev.E.nr.20/2009] të 17 marsit 2010 të Gjykatës Supreme, respektivisht.

89. Ndërsa, në dhjetor të vitit 2009 dhe maj të vitit 2010, respektivisht, pronari i "Nita Commerc" kishte filluar edhe dy procedura të tjera gjyqësore. Të parën, e kishte filluar përmes një kallëzimi penal kundër Bankës, përkatësisht drejtorit të saj dhe punëtorëve A.Sh., M.B. dhe Sh.K., të cilët i akuzonte për ndërhyrje të paautorizuar në llogarinë e saj bankare dhe përvetësimin e shumës prej 79,786,00 euro. Ndërsa, të dytën, e kishte filluar përmes një padie për "*moslejimin e ekzekutimit*" të Aktvendimit [E.nr.406/09] të 11 nëntorit 2009 të Gjykatës Komunale, i cili kishte lejuar përmbarimin e Aktgjykimit [C.nr.207/2006] të 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut.

90. Përkitazi me procesin penal, bazuar në shkresat e lëndës, kallëzimi penal i 17 majit 2010 i "Nita Commerc", më 4 qershor 2013, kishte rezultuar në Aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve A.Sh., M.B. dhe Sh.K., nga Departamenti për Krime të Rënda i Prokurorisë Themelore, nën dyshimin e kryerjes së veprës penale të përvetësimit gjatë detyrës, siç është përcaktuar në dispozitat përkatëse të KPPK-së. Gjithashtu bazuar në shkresat e lëndës rezulton se Prokuroria Themelore në Ferizaj, kishte ngritur Aktakuzën [PP.l.nr. 111/20 J 5] vetëm ndaj personave A.Sh. dhe M.B. Aktakuza ishte ngritur kundër të dyve, por e njëjta ishte ndryshuar nga Prokurori i Shtetit, duke e tërhequr Aktakuzën përkitazi me personin M.B. Më 31 mars 2016, Departamenti për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore, përmes Aktgjykimit [PKR.nr.209/2015] kishte liruar nga akuza edhe personin A.Sh. Ky Aktgjykim më pas ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.392/16] të 15 marsit 2017.

91. Ndërsa, përkitazi me padinë për "*moslejimin e ekzekutimit*" të 19 majit 2010, Gjykata rikujton që tri vite më pas, përkatësisht më 13 shtator 2013, "Nita Commerc", kishte dorëzuar edhe një parashtresë në Gjykatën Komunale, duke kërkuar ndryshimin e kësaj padie në padi për kompenzim dëmi, tashmë në vlerën prej 98,019.43 euro, për dallim prej vlerës fillestare 74,000 euro. Në kontekst të kësaj procedure kontestimore, Gjykata Themelore në Gjakovë përmes Aktvendimit përkatës e kishte shpallur vetën jo kompetente në pikëpamje lëndore, ndërsa në korrik të vitit 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, e kishte ndërprerë procedurën kontestimore derisa të përfundojë lënda penale. Duke marrë parasysh që procedura penale kishte përfunduar në vitin 2016, Gjykata Themelore kishte vazhduar procedurën kontestimore, duke caktuar edhe dy ekspertiza shtesë, përkatësisht ekspertizën financiare të punuar nga eksperti F.K., dhe një tjetër, që do të punohej nga tre ekspertë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. E para kishte konfirmuar se "*nuk ka pasur*

ndonjë dyfishim të veprimeve bankare", duke sqaruar edhe mënyrën e pagesës prej 74,306 euro edhe atë prej 23,930.06 euro, ndërsa e dyta, përkatësisht, ajo e Fakultetit Ekonomik, siç është sqaruar në përmbledhjen e fakteve në këtë rast, nuk ishte dorëzuar asnjëherë në Gjykatën Themelore. Gjykata Themelore, pas shqyrtimit të dëshmive dhe ekspertizave përkatëse, përmes Aktvendimit [I.EK.nr.424/14] të 2 nëntorit 2018, kishte vendosur që çështja në shqyrtim i plotësonte kushtet ligjore për të u kualifikuar si *res judicata*.

92. Pas pesë (5) vendimeve të nxjerra në këtë procedurë kontestimore, përkatësisht (i) tri vendimeve të grupit të parë të cilat kishin vendosur në mënyrë meritore përkitazi me kontestin në mes "Nita Commerc" dhe Bankës, siç janë Aktgjykimi [VIII.C.Nr.207/06] i 23 nëntorit 2006 i Gjykatës Ekonomike të Qarkut, Aktgjykimi [Ae.nr.2/2007] i 17 shtator 2009 i Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimi [Rev E.nr.20/2009] i 17 marsit 2010 i Gjykatës Supreme, dhe përmes të cilave ishin refuzuar të gjitha pretendimet e "Nita Commerc"; dhe (ii) dy (2) vendimeve tjera, të cilat ishin nxjerrë pasi "Nita Commerc" kishte parashtruar padi të re për kompenzim dëmi, përkatësisht Aktvendimit [IV.C.nr.1/2010] të 12 majit 2010 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut dhe Aktvendimit [I.EK.nr.424/14] të 2 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore, i nxjerrë pas përfundimit të procedurës penale, e të cilat kishin konfirmuar se kontesti në mes "Nita Commerc" dhe Bankës, tashmë paraqet "*çështje e gjykuar"* bazuar në pikën d) të nenit 391 të LPK-së, në maj të vitit 2019, duke vepruar sipas ankesës së "Nita Commerc", Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ae.nr.287/18] të 27 majit 2019, i kontestuar në rrethanat e rastit konkret, kishte urdhëruar kthimin e çështjes në rivendosje në merita në Gjykatën Themelore, duke theksuar se kontesti përkatës civil nuk mund të kualifikohet si *res judicata*. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës drejtuar Prokurorit të Shtetit për të iniciuar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër këtij Aktvendimi, ishte refuzuar.

93. Bazuar në këtë Aktvendim të Gjykatës së Apelit, më 1 gusht 2019, kishte rifilluar procedura kontestimore para Gjykatës Themelore, fillimisht (i) përmes Aktvendimit [I.EK.nr.330/19], gjithashtu i kontestuar në rrethanat e rastit konkret, i cili kishte refuzuar kërkesën e Bankës që çështja kontestuese të konsiderohet si "*çështje e gjykuar*"; dhe (ii) ishte caktuar edhe një superkspertizë financiare, e cila, bazuar në shkresat e lëndës rezulton të ketë konstatuar, ndër tjerash, se "*nuk ka pasur ndërhyrje të punëtorëve të bankës në llogarinë e subjektit "Nita Commerc" pa autorizim"*.

94. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon që këto dy Aktvendime, përkatësisht Aktvendimi [Ae.nr.287/18] i 27

majit 2019 i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi [I.EK.nr.330/19] i 1 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, duke theksuar se në rrethanat e rastit të tij është (i) cenuar parimi i sigurisë juridike; dhe (ii) e drejta në vendim të arsyetuar gjyqësor. Këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

95. Rrjedhimisht, dhe në vijim, Gjykata së pari do t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me cenimin e sigurisë juridike, shqyrtim ky në të cilin, Gjykata fillimisht (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme; dhe me pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën e sigurisë juridike dhe respektimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë

96. Lidhur me parimin e sigurisë juridike e që presupozon respektimin e parimit *res judicata*, përkatësisht, parimin e plotfuqishmërisë së vendimeve të formës së prerë, të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë gjyqësore është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet, *Brumarescu kundër Rumanisë,* cituar më lart; *Ryabykh kundër Rusisë*, Aktgjykim i 24 korrikut 2003; *Pravednaya kundër Rusisë,* Aktgjykim i 18 nëntorit 2004; *Tregubenko kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 30 marsit 2005; *Kehaya dhe të tjerët kundër Buligarisë*, Aktgjykim i 12 janarit 2006; *Ponomaryov kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 3 prillit 2008; *Esertas kundër Lituanisë,* Aktgjykim i 31 majit 2012; *Trapeznikov dhe të tjerët kundër Rusisë*, Aktgjykim i 5 prillit 2016; dhe *Vardanyan dhe Nanushyan kundër Armenisë*, Aktgjykim i 27 tetorit 2016. Për më tepër, parimet themelore sa i përket parimit *res judicata*, janë shtjelluar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI132/15, cituar më lart; KI150/16, parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 19 dhjetorit 2018 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI150/16); KI67/16, parashtrues *Lumturije Voca*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 4 janarit 2017 (në tekstin e mëtejmë: rasti i

Gjykatës KI67/16); KI122/17, cituar më lart; dhe KI87/18, cituar më lart.

97. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta për një shqyrtim të drejtë para një gjykate siç garantohet përmes nenit 6 të KEDNJ-së, duhet të interpretohet në dritën e Preambulës së saj, ku ndër të tjera, theksohet që sundimi i ligjit është pjesë e trashëgimisë së përbashkët të Shteteve Kontraktuese. Një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon, ndër të tjera, që atëherë kur gjykatat të kenë vendosur përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në dyshim dhe t'i nënshtrohet shqyrtimeve të mëtejme. (Shih, rastet e GJEDNJ-së *Brumarescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 61; dhe *Vardanyan dhe Nanushyan kundër Armenisë*, cituar më lart, paragrafi 66 dhe referencat e përdoruara aty).

98. Për më tepër, bazuar në këtë praktikë gjyqësore, siguria juridike presupozon respektimin e parimit *res judicata*, që është parimi i formës së prerë të vendimeve gjyqësore. Ky parim nënkupton që asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të plotfuqishëm dhe detyrues gjyqësor thjesht për qëllim të fitimit të mundësisë së rishqyrtimit dhe zgjidhjes së freskët të rastit. Sigurisht që ky parim nuk përjashton ushtrimin e kompetencave të gjykatave më të larta për të korrigjuar gabimet gjyqësore dhe gabimet e drejtësisë, por jo për të kryer thjeshtë një shqyrtim të ri të një rasti i cili tashmë ka marrë formën e prerë. Një rishikim i tillë nuk duhet të trajtohet si një "*ankesë e maskuar*" dhe thjeshtë si mundësi për të pasur dhe trajtuar dy pikëpamje mbi një vendim përfundimtarë. Përjashtime nga një parim i tillë, janë të mundëshme, vetëm nëse justifikohen nga rrethana të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*". (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Ryabykh kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 52).

99. Bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, në vlerësimin nëse përjashtimet nga ky parim janë të justifikueshme përmes rrethanave të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*", duhet të merret parasysh, në veçanti, efekti i rihapjes së rastit dhe çdo procedurë e mëvonshme, mbi situatën individuale të parashtruesit përkatës; nëse rihapja e rastit ka pasuar si rezultat i vetë kërkesës së parashtruesit përkatës; arsyet mbi të cilat autoritetet përkatëse kanë revokuar plotfuqishmërinë e vendimit; pajtueshmërinë e procedurës në fjalë me kërkesat e ligjit të aplikueshëm; ekzistencën dhe funksionimin e garancive procedurale për të parandaluar keqpërdorimin e kësaj procedure; dhe rrethana të tjera përkatëse të rastit. Përveç kësaj, rishikimi duhet të sigurojë të gjitha garancitë procedurale të nenit 6 të

KEDNJ-së dhe duhet të sigurojë drejtësinë e procedurave në tërësinë e saj. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Lenskaya kundër Rusisë*, Aktgjykim i 29 janarit 2009, paragrafi 33 dhe referencat e përdorura aty).

100. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, përfshin raste në të cilat ka konstatuar ose jo shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të cenimit të parimit *res judicata*. Rastet e GJEDNJ-së në të cilat është konstatuar një shkelje e tillë përfshijnë por nuk kufizohen në *Brumaresku kundër Rumanisë*, *Ryabykh kundër Rusisë*, *Pravednaya kundër Rusisë* dhe *Tregubenko kundër Ukrainës* (të gjitha cituar më lart). Në këto raste dhe bazuar në veçoritë e secilës prej tyre, GJEDNJ ndër të tjera, theksoi se (i) një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon që aty ku gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Brumaresku kundër Rumanisë,* cituar më lart, paragrafi 61); (ii) procedurat gjyqësore të mëvonshme nuk mund të anulojnë një proces të tërë gjyqësor i cili ka përfunduar përmes një vendimi gjyqësor që është "*i pakthyeshëm*" dhe për pasojë, *res judicata* (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Brumaresku kundër Rumanisë,* cituar më lart, paragrafi 62); dhe (iii) procedurat gjyqësore pasuese nuk mund të procedojnë bazuar në një "*ankesë të maskuar*" e që nuk reflekton një përpjekje të ndërgjegjshme për të korrigjuar gabime të drejtësisë të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*" (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Pravednaya kundër Rusisë,* cituar më lart, paragrafi 25).

101. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, gjithashtu ka vënë theksin në vlerësimin e efekteve të parimit *res judicata*, përkatësisht kufizimeve *ad personam* dhe atyre të ndërlidhura me fushëveprimin material. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Esertas kundër Lituanisë,* cituar më lart, paragrafët 22 deri 31; dhe gjithashtu *Kehaya dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, cituar më lart, paragrafi 66). Për shembull, në rastin *Esertas kundër Lituanisë*, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, duke theksuar ndër të tjera, që megjithëse pretendimet në të dy grupet e procedurave, përkatësisht procesit të parë dhe të dytë gjyqësor, nuk ishin identike, të dy procedurat civile kishin të bënin saktësisht me të njëjtat marrëdhënie juridike dhe të njëjtat rrethana e të cilat ishin thelbësore për vendosjen e kontestit dhe për këtë arsye, nuk reflektonin as kufizime *ad personam* e as të fushëveprimit material dhe për pasojë, procedurat e para gjyqësore, e kishin arritur statusin e *res judicata*. Në anën tjetër, në rastin e Gjykatës, KI67/16, në shtjellimin e parimeve të përgjithshme përkitazi me parimin *res judicata*, Gjykata duke u referuar në rastet *Esertas kundër Lituanisë* dhe *Kehaya dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, gjithashtu kishte

theksuar rëndësinë e vlerësimit të efekteve të parimit *res judicata*, duke përshirë *ad personam* (për një person të caktuar) dhe në fushëveprimin material (çështja e caktuar). (Shih, rastin e Gjykatës KI67/16, cituar më lart, paragrafët 85 deri 88). Gjykata, në këtë rast, nuk kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, pasi kishte vlerësuar se në rrethanat e rastit përkatës, pretendimet e parashtrueses përkatëse se vendimi i kontestuar ishte bërë *res judicata*, nuk ishin të bazuara sepse i njëjti kishte dallime *ad personam* dhe kuptim të fushëveprimit material. (Shih, rastin e Gjykatës KI67/16, cituar më lart, paragrafët 95 deri 99).

102. Rrjedhimisht, dhe bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, në parim, një vendim merr formën e prerë dhe arrin statusin e *res judicata* nëse (i) vendimi përkatës është i parevokueshëm sepse nuk ka mjete të mëtejshme në dispozicion; (ii) kur afati për shfrytëzimin e të njëjtave ka përfunduar; dhe (iii) kur nuk ka kufizime *ad personam* edhe në fushëveprimin material. Siç është sqaruar më lart, përjashtime nga ky parim, mund të jenë të justifikueshme, vetëm si rezultat i rrethanave të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*". Prandaj, në aplikimin e këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret, Gjykata, në vijim, fillimisht do të vlerësojë nëse rrethanat e rastit përfshijnë vendime të formës *res judicata* dhe nëse po, nëse rihapja e tyre është e justifikueshme bazuar në rrethana të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*".

(ii) Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

103. Në aplikimin e parimeve të përgjithshme të shtjelluara më lart, Gjykata edhe një herë rikujton që në rrethanat e rastit konkret janë zhvilluar tri procedura konstimore, (i) në të cilat janë të përfshira të njëjtat palë, "Nita Commerc" dhe Banka, respektivisht; dhe (ii) të cilat ndërlidhen, në esencë, me të njëjtën çështje, përkatësisht kontestin që buron nga Kontrata për Kredinë dhe Marrëveshja për Kolateralin e nënshkruar më 2 korrik 2003.

104. Gjykata rikujton që në procedurën e parë kontestimore, Gjykata Ekonomike e Qarkut kishte vendosur në favor të Bankës, përmes Aktgjykimit [VIII.C.Nr.207/06] të 23 nëntorit 2006. Ky Aktgjykim gjithashtu kishte adresuar pretendimet e "Nita Commerc" lidhur me ndërhyrjen e paautorizuar të punëtorëve të Bankës në llogarinë e saj në vlerën prej 74,343.00 euro, duke i refuzuar të njëjtat si të pabazuara. Ky Aktgjykim i Gjykatës Ekonomike të Qarkut, ishte vërtetuar edhe përmes dy Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, Aktgjykimit [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 dhe Aktgjykimit [Rev.E.nr.20/2009] të 17 marsit 2010, respektivisht. Përtej

Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, nuk kishte mjete të mëtejme juridike në dispozicion, dhe rrjedhimisht, Aktgjykimi përkatës i Gjykatës Ekonomike të Qarkut, ishte bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm. Bazuar në shkresat e lëndës, propozimi i Bankës për përmbarim ishte lejuar përmes Aktvendimit [E.nr.406/09] të Gjykatës Komunale, ndërsa, më 26 korrik 2013, kishte përfunduar ekzekutimi i procedurës përmbarimore lidhur me hipotekën që ishte lënë peng për sigurimin e kredisë nga "Nita Commerc".

105. Megjithatë, dhe siç është sqaruar më lart, "Nita Commerc" kishte filluar procedurë të re gjyqësore përmes dy kërkesëpadive të reja. E para ishte dorëzuar në Gjykatën Ekonomike të Qarkut, më 31 dhjetor 2009, "*për shkak të fitimit të pabazë*", me pretendimin e ndërhyrjes së paautorizuar të punëtorëve të Bankës në llogarinë e saj bankare. Ndërsa e dyta, ishte dorëzuar në Degën e Malishevës të Gjykatës Themelore në Gjakovë, më 13 shtator 2013, duke kërkuar ndryshimin e kërkesëpadisë së 19 majit 2010, në kërkesë për kompenzim dëmi si rezultat i ndërhyrjes së paautorizuar të punëtorëve të Bankës në llogarinë e saj bankare. Të dy gjykatat përkatëse, përkatësisht Gjykata Ekonomike e Qarkut përmes Aktvendimit [IV.C.nr.1/2010] të 12 majit 2010 dhe Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktvendimit [I.EK.nr.424/14] të 2 nëntorit 2018, kishin hedhur poshtë kërkesëpaditë përkatëse, bazuar në nenin 391 të LPK-së, duke vlerësuar se çështjet e ngritura para tyre, tashmë ishin gjykuar dhe rrjedhimisht kishin statusin e *res judiciata*. Për më tepër, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte arritur këtë konstatim vetëm pasi (i) fillimisht e kishte ndërprerë procedurën kontestimore derisa kishte përfunduar çështja përkatëse penale e ndërlidhur me pretendimin e ndërhyrjes së paautorizuar të punëtorëve të Bankës në llogarinë bankare të "Nita Commerc"; dhe (ii) pasi kishte urdhëruar dy ekspertiza dhe kishte vërtetuar se pretendimet e "Nita Commerc" përkitazi me "*ndërhyrjen e paautorizuar në llogarinë e tij*" nga punëtorët e Bankës ishin të pabazuara, për më tepër që të njëjtat ishin adresuar që në Aktgjykimin e parë të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, përkatësisht Aktgjykimin [VIII.C.Nr.207/06] e 23 nëntorit 2006 përkitazi më këtë çështje konstimore dhe rrjedhimisht, përbënin "*çështje të gjykuar*" ose *res judicata*.

106. Gjykata gjithashtu rikujton që deri në nxjerrjen e Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, dhe i cili e kishte cilësuar kërkesëpadinë e "Nita Commerc" si *res judicata*, kishte përfunduar në tërësi procedura penale e cila kishte filluar përmes kallëzimit penal të "Nita Commerc" më 17 maj 2010. Gjykata më saktësisht rikujton se (i) Aktvendimi për fillimin e hetimeve ishte nxjerrë kundër tre punëtorëve të Bankës, A.Sh., M.B. dhe Sh.K., respektivisht; (ii)

Aktakuza ishte ngritur vetëm kundër dy prej tyre, A.Sh. dhe M.B., respektivisht; (iii) Aktakuza në ndërkohë ishte tërhequr përkitazi me personin M.B.; dhe (iv) përmes Aktgjykimit [PKR.nr.209/2015] të 31 marsit 2016 të Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore, ishte liruar nga akuza edhe personit i fundit, përkatësisht A.Sh. Për më tepër, bazuar në shkresat e lëndës, ky Aktgjykim i Gjykatës Themelore ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.392/16] më 15 mars 2017, dhe rrjedhimisht ishte bërë i formës së prerë.

107. Megjithatë, duke vepruar sipas ankesës së "Nita Commerc", më 27 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ae.nr.287/18], e ktheu çështjen në rivendosje përkitazi me meritat e rastit. Përmes këtij Aktvendimi, Gjykata e Apelit, kishte arsyetuar, ndër tjerash, si në vijim:

> *"Përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 par 1lidhur me nenin 391 par 1 pika d) e LPK-së* [...] *se ankesa e paditëses është e bazuar, për arsye se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë se në këtë kontest civil, pozita e palëve në procedurë është e ndryshme sikur që është e ndryshme edhe baza juridike si dhe vlera e kontestit, respektivisht me aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike te Qarkut në Prishtinë VIIIC.nr.207/06 e datës 23/11/2006, është gjykuar çështja e pagimit të borxhit, ndërsa tani objekt kontesti është kompensimi i dëmit qe pretendohet se e paditura gjegjësisht zyrtaret e saj i kane shkaktuar dëme paditëses duke përvetësuar të hollat nga gjiro-llogaria e saj, në mënyrë të kundërligjshme dhe kundër të cilëve kanë filluar hetimet penale, por deri më tani nuk dihet epilogu i kësaj procedure penale, andaj në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të zbatuar dispozitat ligjore te nenit 391 pika d) te LPK-së sepse kërkesa e padis nuk ka te beje me çështje e cila më parë është vendosur me vendim te plotfuqishëm gjyqësor. Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara, të cilat në riprocedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që fillimisht të të vërteton bazën juridike të kërkesëpadisë dhe pastaj nëse vërtetohet baza juridike atëherë gjykata me propozim palëve mund të nxjerrë prova materiale për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë [...]."*

108. Bazuar në arsyetimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit, rezulton se e njëjta kishte konstatuar që nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të zbatuar pikën d) të nenit 391 të LPK-së, dhe rrjedhimisht çështja nuk e kishte arritur statusin e *res judicata*, sepse në raport me Aktgjykimin [VIII.C.nr.207/06] e 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut (i) pozita e palëve në procedurë është e ndryshme; dhe (ii) baza juridike dhe vlera e kontestit janë të ndryshme. Për më tepër, Gjykata e Apelit kishte theksuar gjithashtu se në procedurën e zhvilluar në Gjykatën Ekonomike të Qarkut "*është gjykuar çështja e pagimit të borxhit*", ndërsa para saj kontestuese ishte "*kompensimi i dëmit që pretendohet se e paditura, gjegjësisht zyrtarët e saj i kanë shkaktuar dëme paditëses, duke përvetësuar të hollat nga gjiro-llogaria e saj, në mënyrë të kundërligjshme*" dhe "*kundër të cilëve kanë filluar hetimet penale, por deri më tani nuk dihet epilogu i kësaj procedure penale*".

109. Në kontekst të arsyetimit të Akvendimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata fillimisht thekson se, në rrethanat e rastit konkret, nuk është kontestuese që Aktgjykimi [VIII.C.Nr.207/06] i 23 nëntorit 2006 i Gjykatës Ekonomike të Qarkut, i konfirmuar dy herë përmes Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimeve [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 dhe [Rev.E.nr.20/2009] të 17 marsit 2010, respektivisht, dhe për më tepër, i cili ishte përmbaruar bazuar në Aktvendimin [E.nr.406/09] e 11 nëntorit 2009 e Gjykatës Komunale në Malishevë, është *res judicata*. Megjithatë, siç është shtjelluar në parimet e përgjithshme përkitazi me parimin e sigurisë juridike, për të konstatuar nëse përmes Aktvendimit të kontestuar, Gjykata e Apelit ka rihapur procedura gjyqësore të cilat kanë arritur statusin e *res judicata*, Gjykata duhet të vlerësojë nëse çështja në shqyrtim para Gjykatës së Apelit, reflekton (i) kufizime *ad personam;* ose (ii) të fushëveprimit material.

110. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht vëren se (i) palët në të gjitha procedurat kontestimore kanë qenë identike, "Nita Commerc" dhe Banka, respektivisht; (ii) çështja kontestimore në të gjitha procedurat buron nga Kontrata për Kredinë dhe Marrëveshja për Kolateralin e nënshkruar më 2 korrik 2003; (iii) procedura e parë kontesimore që ishte përmbyllur përmes Aktgjykimit [VIII.C.Nr.207/06] të 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut dhe ishte vërtetuar edhe përmes dy Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, Aktgjykimit [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 dhe Aktgjykimit [Rev. E.nr.20/2009] të 17 marsit 2010, respektivisht, kishte vlerësuar edhe pretendimet e "Nita Commerc" përkitazi me ndërhyrjen e paautorizuar të punëtorëve të Bankës në llogarinë e saj, duke e refuzuar këtë pretendim si të pabazuara bazuar në ekspertizën

përkatëse; dhe (iv) edhe dy Aktvendime, përkatësisht Aktvendimi [IV.C.nr.1/2010] i 12 majit 2010 i Gjykatës Ekonomike e Qarkut dhe Aktvendimi [I.EK.nr.424/14] i 2 nëntorit 2018 i Gjykatës Themelore, që ishin nxjerrë bazuar në paditë e reja dhe pasuese të "Nita Commerc", kishin trajtuar pretendimet e saj përkitazi me ndërhyrjen e paautorizuar të punëtorëve të Bankës në llogarinë përkatëse, duke i refuzuar të njëjtat si të pabazuara dhe duke e kualifikuar çështjen si *res judicata* bazuar në nenin 391 të LPK-së.

111. Prandaj, bazuar në sqarimet e mësipërme dhe specifikisht përkitazi me kufizimet ad personam, Gjykata thekson se nuk është kontestuese që në rrethanat e rastit konkret, nuk ka kufizime të tilla, sepse përgjatë tri procedurave kontestimore palët në procedurë kanë qenë identike, Banka dhe "Nita Commerc", respektivisht.

112. Për më tepër, përkitazi me kufizimet në fushëveprimin material, Gjykata vëren që është e saktë që për dallim prej padisë fillestare të ngritur para Gjykatës Ekonomike të Qarkut më 14 korrik 2006 dhe e cila ndërlidhej me vërtetimin e borxhit të "Nita Commerc" ndaj Bankës në tërësinë e tij e që buron nga Marrëveshja për Kredinë dhe Kolaterialin të 2 korrikut 2003, padia në shqyrtim para Gjykatës Themelore vendimi i së cilës ishte kontestuar para Gjykatës së Apelit, ndërlidhej vetëm me kërkesën për kompenzim dëmi si rezultat i pretendimit të "Nita Commerc" se kishte pasur ndërhyrje të paautorizuar në llogarinë e saj bankare nga punëtorët e Bankës. Është gjithashtu e saktë që vlera e kontestuar ka ndryshuar nëpër instanca gjyqësore varësisht prej padive përkatëse të "Nita Commerc". Më saktësisht (i) në procedurën e parë kontestimore para Gjykatës Ekonomike të Qarkut të vendosur përmes Aktgjykimit [VIII.C.Nr.207/06] të 23 nëntorit 2006, ishte kontestuar dhe shqyrtuar shuma prej 74,343.00 euro; (ii) në padinë e radhës të parashtruar para Gjykatës Ekonomike të Qarkut të vendosur përmes Aktvendimit [IV.C.nr.1/2010] të 12 majit 2010, ishte kontestuar dhe shqyrtuar shuma prej 74.360.00 euro; ndërsa (iii) në padinë për kompenzim dëmi të 13 shtatorit 2013, "Nita Commerc" kishte kërkuar kompenzimin e dëmit në vlerën prej 98,019.43 euro. Kjo e fundit, bazuar në ekspertizën e 24 nëntorit 2016, përbëhej nga vlera prej 74,089.37 euro e që ndërlidhej me pretendimin për ndërhyrjen e paautorizuar të punëtorëve të Bankës në llogarinë e "Nita Commerc" dhe nga vlera prej 23,930.06 euro si "*mjete të papërfshira në pasqyrat e llogarisë*". E njëjta ekspertizë përkitazi me vlerën e parë, kishte konstatuar se "*pagesat e kryera në emër të detyrimeve doganore (8 veprime në vlerë prej 74,306 euro) nuk kanë sjellë ndonjë dëm për kompaninë "Nita Commerc" dhe nuk ka pasur ndonjë dyfishim të veprimeve bankare*", ndërsa përktazi me të dytën, kishte

konstatuar se "*vlera prej 1,610 euro ka të bëjë me provizionet në emër të kredive të lejuara, ndërsa vlera prej 1,455 fillimisht është regjistruar në dëm të klientit mirëpo më vonë banka ka kryer stronimet e duhura*", ndërsa "*vlera e mbetur prej 20,837.90 euro paraqet obligimet kreditore të klientit ndaj bankës dhe për këtë gjykata ka marr vendim*".

113. Megjithatë, Gjykata thekson se përkundër ndryshimeve në vlerën e kontestuar nëpër procedura gjyqësore, kjo shumë kontestuese ndërlidhet me të njëjtin pretendim të "Nita Commerc", përkatësisht me pretendimin për ndërhyrje të paautorizuar në llogarinë përkatëse bankare nga punëtorët e Bankës, pretendim ky i cili ishte (i) shqyrtuar që në procedurën e parë kontestimore dhe ishte refuzuar përmes Aktgjykimit [VIII.C.Nr.207/06] të 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut e të konfirmuar përmes dy Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, Aktgjykimit [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 dhe Aktgjykimit [Rev. E.nr.20/2009] të 17 marsit 2010 të Gjykatës Supreme,respektivisht; (ii) shqyrtuar dhe refuzuar përmes Aktvendimit [IV.C.nr.1/2010] të 12 maj 2010 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut dhe e cila e kishte trajtuar çështjen si *res judicata*; dhe (iii) shqyrtuar dhe refuzuar përmes Aktvendimit [I.EK.nr.424/14] të 2 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore, të nxjerrë pasi kishte përfunduar procedura përkatëse penale dhe bazuar në ekspertizat përkatëse, dhe e cila gjithashtu kishte trajtuar çështjen si *res judicata*.

114. Për më tepër, Gjykata rikujton gjithashtu se përgjatë gjithë zhvillimit të këtyre procedurave konstimore për më shumë se dhjetë (10) vite dhe deri në Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, gjykatat e rregullta, kishin urdhëruar kryerjen e tri ekspertizave të ndryshme. E para ishte përcaktuar nga Gjykata Ekonomike e Qarkut dhe ishte dorëzuar në të njëjtën me 30 tetor 2006. E dyta dhe treta, ishin caktuar nga Gjykata Themelore, pasi kishte rifilluar shqyrtimin e kontestit në mes palëve. Njëra i ishte përcaktuar ekspertit F.K., ndërsa tjetra, Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Ajo e ekspertit F.K. ishte dorëzuar në Gjykatën Themelore më 24 nëntor 2016, ndërsa ajo e Fakultetit Ekonomik, nuk ishte dorëzuar asnjëherë, duke rezultuar në dënim më gjobë të shqiptuar nga Gjykata Themelore, profesorëve përkatës të përcaktuar për të përfunduar këtë ekspertizë. Ekspertizat përkatëse, kishin konstatuar, në parim, se pretendimet e "Nita Commerc" se kishte patur ndërhyrje të paautorizuar të punëtorëve të Bankës në llogarinë e saj bankare ishin shqyrtuar që në procedurën e parë kontestimore, për më tepër që sipas të njëjtave, pretendimet për një ndërhyrje të tillë, ishin të pabazuara. Ndër të tjera dhe bazuar në këto ekspertiza, gjykatat e rregullta e kishin kualifikuar çështjen si *res judicata*. Gjithashtu, bazuar në

shkresat e lëndës, një ekspertizë e katërt është urdhëruar nga Gjykata Themelore, pasi Gjykata e Apelit e kishte kthyer çështjen në rivendosje në merita, duke refuzuar kualifikimin e kësaj çështje kontestimore si *res judicata*. Ekspertiza e fundit, e cila ishte punuar nga tre (3) ekspert financiar, i ishte dorëzuar Gjykatës Themelore më 14 nëntor 2019 dhe konstatimet e të njëjtës konfirmojnë, në parim, ato të ekspertizave paraprake.

115. Bazuar në si më sipër, në rrethanat e rastit konkret, në kontekst të kufizimeve të fushëveprimit material, Gjykata rithekson se përkundër dallimeve në vlerën përkatëse të kontestuar nëpër procedura gjyqësore, të njëjtat ndërlidhen me të njëjtin pretendim të "Nita Commerc", përkatësisht pretendimin se në llogarinë e saj kishte ndërhyrje të paautorizuar të punëtorëve të Bankës, dhe rrjedhimisht, ngërthen të njëjtën çështje kontestuese dhe e cila është thelbësore për vendosjen e kontestit përkatës. Për pasojë, Gjykata nuk konsideron që çështja kontestuese para Gjykatës së Apelit të ketë ngërthyer kufizime në fushëveprimin material.

116. Prandaj, Gjykata thekson se çështja e cila u shqyrtua para Gjykatës së Apelit përmes Aktvendimit të kontestuar (i) nuk kishte kufizime ad personam; dhe as (ii) të fushëveprimit material. Më saktësisht, përkundër arsyetimit të Gjykatës së Apelit, në Aktvendimin e kontestuar, përkatësisht Aktvendimin [Ae.nr.287/18] e 27 majit 2019, se (i) pozita e palëve në procedurë është e ndryshme; dhe (ii) baza juridike dhe vlera e kontestit janë të ndryshme, çështja në shqyrtim para saj, në fakt, ngërthente (i) të njëjtat palë; dhe (ii) të njëjtën çështje e cila tashmë ishte zgjidhur përmes një vendimi të formës së prerë, përkatësisht Aktgjykimit [VIII.C.Nr.207/06] të 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, dhe i cili, siç kishte konstatuar edhe Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [I.EK.nr.424/14] të 2 nëntorit 2018, ishte *res judicata*.

117. Në mbështetje të këtij konstatimi, Gjykata i referohet rastit të GJEDNJ-së, *Esertas kundër Lituanisë* (Aktgjykimi i 31 majit 2012), i cili ndërlidhet një kontest civil në mes të një parashtruesi dhe një kompanie për shërbime të ngrohjes. Dy grupe të procedurave u zhvilluan midis të të njëjtave palë. Fillimisht, Gjykata e Rrethit të qytetit përkatës vendosi në favor të parashtruesit të kërkesës. Pala kundërshtare nuk e parashtroi ankesën përkatëse me kohë. Megjithatë, më pas, ngjashëm si në rrethanat e rastit konkret, pala kundërshtare paraqiti kërkesëpadi të re kundër parashtruesit përkatës. Gjykata e Rrethit e mbështeti kërkesën, duke arsyetuar, ndër të tjera, se vendimi i parë i gjykatës "*nuk kishte efekt res judicata pasi kërkesa e re kishte të bënte me një periudhë të ndryshme kohore, dhe*

se kjo situatë nuk ishte identike me atë të vendosur më parë". Gjykata Rajonale gjithashtu mbështeti këtë vendim. GJEDNJ, në shqyrtimin e rastit përkatës, konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. GJEDNJ, ndër të tjera, arsyetoi se (i) megjithëse pretendimet në të dy grupet e procedurave nuk ishin identike, të dy procedurat civile kishin të bënin saktësisht me të njëjtat marrëdhënie juridike dhe të njëjtat rrethana, të cilat ishin thelbësore për vendosjen e kontestit; (ii) nuk kishte asnjë justifikim për të kërkuar nga parashtruesi i kërkesës të dëshmojë përsëri, në procedurën e dytë, faktin se ai nuk ishte në marrëdhënie kontraktuale me palën kundërshtare ose që nuk ishin ofruar shërbimet përkatëse sepse këto rrethana ishin vërtetuar në grupin e parë të procedurave; (iii) shmangja nga parimi i sigurisë juridike do të ishte në përputhje me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së vetëm nëse arsyetohet nga nevoja për të korrigjuar një defekt me rëndësi thelbësore për sistemin gjyqësor, ndërsa në rrethanat e rastit përkatës, ky nuk ishte rasti; (iv) grupi i dytë i procedurave thjesht interpretoi dhe zbatoi ligjin ndryshe, gjë që nuk përbën një defekt me rëndësi thelbësore brenda kuptimit të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe nuk mund të justifikojë largimin/shmangjen nga parimi i sigurisë juridike; dhe (v) duke privuar nga efekti *res judicata* vendimin përfundimtar të 7 qershorit 2004, gjykatat vendore vepruan në shkelje të parimit të sigurisë juridike të garantuara përmes nenit 6 të KEDNJ-së.

118. Ngjashëm në rrethanat e rastit konkret, (i) megjithëse pretendimet në të tri grupet e procedurave nuk ishin identike, të gjitha kishin të bënin saktësisht me të njëjtat marrëdhënie juridike dhe të njëjtat rrethana, të cilat ishin thelbësore për vendosjen e kontestit; dhe (ii) procedura që rezultoi në Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, thjesht interpretoi dhe zbatoi ligjin ndryshe, duke konstatuar që në këtë rast nuk ishin plotësuar kushtet për të zbatuar pikën d) të nenit 391 të LPK-së, përkatësisht për të kualifikuar çështjen kontestuese si "*çështje të gjykuar*".

119. Në këtë kontekst, nuk është kontestuese se Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ae.nr.287/18] të 27 majit 2019, ka rihapur procedura që tashmë kishin arritur statusin e *res judicata*, por nëse rihapja e këtyre procedurave dhe kthimi i çështjes në rivendosje në Gjykatën Themelore, ngërthen rrethana të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*", që do të mund të arsyetoheshin përmes nevojës për të korrigjuar një defekt me rëndësi thelbësore në vendimmarrjen paraprake të gjykatave, gjë që bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, siç është sqaruar në shtjellimin e parimeve të përgjithshme më lart, do të mund të ishte në përputhje

me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

120. Në vlerësimin nëse rihapja e procedurave që kanë arritur statusin e *res judicata* nga Gjykata e Apelit, në rrethanat e rastit konkret, mund të justifikohet përmes rrethanave të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*", Gjykata vëren se Gjykata e Apelit, edhe pse jo në mënyrë të qartë, duket se arsyeton, kthimin e çështjes në rivendosje në Gjykatën Themelore, bazuar në faktin se procedura penale përkitazi me kallëzimin penal e "Nita Commerc" se punëtorët e Bankës kishin ndërhyrë në mënyrë të paautorizuar në llogarinë e saj bankare, nuk kishte përfunduar ende, duke theksuar se "*deri më tani nuk dihet epilogu i kësaj procedure penale*". Megjithatë, Gjykata rikujton se (i) kallëzimi përkatës penal kundër të pandehurve A.Sh., M.B. dhe Sh.K., ishte dorëzuar më 17 maj 2010; (ii) Aktvendimi për fillimin e hetimeve ishte nxjerrë më 4 qershor 2013; (iii) Aktakuza ishte ngritur më 5 dhjetor 2015 vetëm ndaj personave A.Sh. dhe M.B., ndërsa më pas ishte tërhequr përkitazi me personin M.B.; (iv) përmes Aktgjykimit [PKR.nr.209/2015] të 31 marsit 2016 ishte liruar nga akuza edhe personi A.Sh; dhe (v) Aktgjykimi i lartcekur lirues ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.392/16] të 15 marsit 2017. Për më tepër, siç është sqaruar tashmë, Gjykata Themelore kishte ndërprerë procedurën konstimore përmes Aktvendimit përkatës derisa ishte nxjerrë Aktgjykimi lirues në procedurë penale, dhe më pas e kishte vazhduar të njëjtën, duke e hedhur poshtë padinë përkatëse mbi bazën e *res judicata*.

121. Prandaj, Gjykata thekson se në momentin kur Gjykata e Apelit, kishte nxjerrë Aktvendimin e kontestuar më 27 maj 2019, kishte përfunduar procedura përkatëse penale përmes një Aktgjykimi lirues të Gjykatës Themelore të 31 marsit 2016 dhe një Aktgjykimi të Gjykatës së Apelit duke e konfirmuar të njëjtin më 15 mars 2017. Prandaj, më datë 27 maj 2019, përkatësisht datën e nxjerrjes së Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, arsyetimi i saj se "*deri më tani nuk dihet epilogu i kësaj procedure penale*", nuk qëndron dhe është në kundërshtim me të gjitha rrethanat faktike të rastit. Përkundrazi, procedura përkatëse penale kishte përfunduar dhe "*epilogu*" i saj ishte i qartë që para nxjerrjes së Aktvendimit të Gjykatës Themelore të kontestuar para Gjykatës së Apelit. Bazuar në Aktgjykimet përkatëse të gjykatave të rregullta në procedurë penale, nuk ishte vërtetuar të ketë pasur ndërhyrje të paautorizuar të punëtorëve të Bankës në llogarinë bankare të "Nita Commerc".

122. Gjykata duhet të konstatojë gjithashtu se rihapja e vendimeve që kishin arritur statusin e *res judicata*, në rrethanat e rastit konkret, nuk

mund të arsyetohet përmes nevojës për të korrigjuar një defekt me rëndësi thelbësore në vendimmarrjen paraprake të gjykatave. Gjykatat e rregullta, në një mori procedurash paraprake, kishin vendosur përkitazi me të gjitha pretendimet e palëve identike dhe përkitazi me të njëjtat çështje kontestuese, dhe gjithashtu procedura penale nuk kishte rezultuar në asnjë dyshim i cili do të mund të ngërthente nevojën e rihapjes së procedurave përkatëse më qëllim të korrigjimit të ndonjë defekti më rëndësi thelbësore për drejtësinë. Për pasojë, rihapja e procedurave gjyqësore në rastin konkret, nuk ngërthen asnjë rrethanë të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*", e që do të mund të justifikonte shmangjen nga parimi i sigurisë juridike.

123. Gjykata, për më tepër, thekson se shmangja nga parimi i sigurisë juridike ishte i pajustifikuar në grupin e tretë të procedurave dhe gjithashtu thekson se Aktvendimi [Ae.nr.287/18] i 27 majit 2019 i Gjykatës së Apelit, anuloi një proces të tërë gjyqësor i cili kishte përfunduar në vendime gjyqësore që ishin "*të pakthyeshme*" dhe rrjedhimisht, *res judicata* dhe që për më tepër, ishin ekzekutuar. Duke privuar nga efekti *res judicata* Aktgjykimin [VIII.C.Nr.207/06] e 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, përmes Aktvendimit [Ae.nr.287/18] të 27 majit 2019, Gjykata e Apelit, rrjedhimisht veproi në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 KEDNJ-së. (Shih, për konstatim të ngjashëm, rastin e GJEDNJ-së, *Kehaya dhe të Tjerët kundër Bullgarisë*, cituar më lart, paragrafi 67).

124. Gjykata gjithashtu rikujton që pas nxjerrjes së Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, Gjykata Themelore, më 1 gusht 2019, përmes Aktvendimit [I.EK.nr.330/19] refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës që çështja kontestuese të konsiderohet si "*çështje e gjykuar*" dhe vendosi që procedura të vazhdojë me shqyrtim meritor të kërkesëpadisë. Parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës e konteston edhe këtë Aktvendim të Gjykatës Themelore. Duke marrë parasysh që Gjykata tashmë ka konstatuar se (i) Aktgjykimi [VIII.C.Nr.207/06] i 23 nëntorit 2006 i Gjykatës Ekonomike të Qarkut është *res judicata*; dhe (ii) Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, përkatësisht Aktvendimi [Ae.nr.287/18] i 27 majit 2019, ka rihapur një procedurë gjyqësore që ka arritur statusin e *res judicata* pa asnjë arsyetim të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*", në dëm të parimit të sigurisë juridike në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, gjithashtu duhet të konstatojë që edhe Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Themelore, përkatësisht Aktvendimi [I.EK.nr.330/19] i 1 gushtit 2019, i cili kishte refuzuar kualifikimin e

çështjes kontestimore si *res judicata,* por kishte vendosur që të procedohet me shqyrtimin e meritave të rastit, është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe për pasojë, edhe me nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së.

125. Përfundmisht, duke u bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, Gjykata thekson se (i) megjithëse pretendimet në tri grupet e procedurave nuk ishin identike, të gjitha procedurat civile kishin të bënin saktësisht me të njëjtat marrëdhënie juridike dhe të njëjtat rrethana, të cilat ishin thelbësore për vendosjen e kontestit; (ii) nuk kishte asnjë justifikim për të kërkuar nga palët që të dëshmojnë përsëri, në procedurën e dytë e tretë, se kishte ose jo ndërhyrje të paautorizuar të punëtorëve të Bankës në llogaritë bankare të "Nita Commerc"; (iii) për më tepër që, procedura penale e filluar përmes kallëzimit penal me pretendimin se kishte pasur ndërhyrje të paautorizuar të punëtorëve të Bankës në llogarinë bankare të "Nita Commerc", kishte përfunduar përmes Aktgjykimit lirues ndaj punëtorëve përkatës të Bankës, para Aktvendimeve të kontestuara të Gjykatës së Apelit dhe Themelore respektivisht, dhe të cilat kishin rihapur procedura gjyqësore të cilat ishin bërë të formës së prerë dhe për më tepër, ishin ekzekutuar; (iv) shmangja nga parimi i sigurisë juridike do të ishte në përputhje me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së vetëm nëse do të mund të arsyetohej nga nevoja për të korrigjuar një defekt me rëndësi thelbësore për sistemin gjyqësor, ndërsa në rrethanat e rastit konkret, ky nuk është rasti; (v) grupi i tretë i procedurave thjesht rezultoi në interpretim dhe zbatim ndryshe të ligjit të aplikueshëm bazuar në një "*ankesë të maskuar*" dhe nuk reflekton një përpjekje të ndërgjegjshme për të korrigjuar gabime të drejtësisë të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*", përkatësisht një defekti me rëndësi thelbësore brenda kuptimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së dhe rrjedhimisht, një procedurë e tillë, nuk mund të justifikojë largimin/shmangjen nga parimi i sigurisë juridike; dhe (vi) duke privuar nga efekti *res judicata* Aktgjykimin [VIII.C.Nr.207/06] e 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ae.nr.287/18] të 27 majit 2019 dhe Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [I.EK.nr.330/19] të 1 gushtit 2019, vepruan në shkelje të parimit të sigurisë juridike, të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

126. Prandaj, duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konstaton se Aktvendimi [Ae.nr.287/18] i 27 majit 2019 i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi [I.EK.nr.330/19] i 1 gushtit 2019 i Gjykatës Themelore, janë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike të mishëruar në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me

nenin 6 të KEDNJ-së, sepse kanë rihapur vendime përfundimtare të gjykatave që kishin statusin e *res judicata*, pa asnjë arsyetim apo rrethanë të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*". Si të tilla, të dyja janë në kundërshtim më Kushtetutën dhe rrjedhimisht, të pavlefshme.

127. Gjykata, duke marrë parasysh që ajo tashmë ka konstatuar që Aktvendimet e kontestuara të Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore, respektivisht, nuk janë në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të cenimit të parimit të sigurisë juridike, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht ato që ndërlidhen me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor.

128. Gjykata, në fund, gjithashtu vëren që bazuar në shkresat e lëndës, pasi që parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë, duke kontestuar dy Aktvendimet e lartcekura, Gjykata Themelore në ndërkohë ka vendosur për meritat e rastit përmes Aktgjykimit [I.EK.nr.330/19] të 20 qershorit 2020, duke refuzuar të gjitha pretendimet e "Nita Commerc" si të pabazuara, ndërsa bazuar në ankesën e "Nita Commerc", çështja është në shqyrtim e sipër në Gjykatën e Apelit. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se duke marrë parasysh shpalljen në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së të (i) Aktvendimit [Ae.nr.287/18] të 27 majit 2019 të Gjykatës së Apelit; dhe (ii) Aktvendimit [I.EK.nr.330/19] të 1 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore, bazuar në të cilat, është proceduar në shqyrtimin e meritave në rrethanat e rastit përkatës, çdo procedurë e mëtejmë përkitazi me rastin konkret, është po ashtu në kundërshtim me nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së.

Përfundime

129. Gjykata, në rrethanat e këtij rasti, ka vlerësuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me cenimin e sigurisë juridike, e drejtë kjo e garantuar, sipas sqarimeve të këtij Aktgjykimi, përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenit 6 të KEDNJ-së.

130. Më saktësisht, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerësoi kushtetutshmërinë e dy Aktvendimeve, përkatësisht Aktvendimit [Ae.nr.287/18] të 27 majit 2019 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimit [I.E.nr.330/19] të 1 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore, dhe të cilat sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, kishin rihapur një procedurë gjyqësore e cila është përmbyllur përmes Aktgjykimit [VIII.C.Nr.207/06] të 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të

Qarkut dhe të konfirmuar më pas, përmes dy Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme.

131. Në vlerësimin e pretendimeve përkatëse, Gjykata fillimisht ka shtjelluar parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika e saj gjyqësore dhe ajo e GJEDNJ-së, përkitazi me parimin e sigurisë juridike, përkatësisht, parimin e plotfuqishmërisë së vendimeve të formës së prerë, duke sqaruar, ndër të tjera, se (i) një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon, ndër të tjera, që atëherë kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në dyshim dhe të i nënshtrohet shqyrtimeve të mëtejme; (ii) asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të plotfuqishëm dhe detyrues gjyqësor thjesht për qëllim të fitimit të mundësisë së rishqyrtimit dhe zgjidhjes së freskët të rastit, posaqërisht përmes një "*ankese të maskuar*"; dhe (iii) përjashtime nga një parim i tillë, janë të mundshme vetëm nëse justifikohen nga rrethanat e një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*".

132. Në këtë kontekst, Gjykata, duke aplikuar parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, përkitazi me parimin e sigurisë juridike, fillimisht vlerësoi nëse dy Aktvendimet e kontestuara, kishin rihapur vendime paraprake që kishin arritur statusin e *res judicata*, duke përfshirë nëse çështjet para tyre ngërthenin kufizime ad personam dhe/ose të fushëveprimit material, dhe nëse ky është rasti, nëse rihapja e tyre ishte e justifikuar nga rrethana të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*".

133. Përkitazi më çështjen e parë, Gjykata konstatoi se Aktvendimet e kontestuara të Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore, respektivisht, kishin rihapur procedura të cilat tashmë, kishin arritur statusin e *res judicata*, përmes Aktgjykimit [VIII.C.Nr.207/06] të 23 nëntorit 2006 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, siç ishte konfirmuar edhe përmes dy Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, Aktgjykimit [Ae.nr.2/2007] të 17 shtatorit 2009 dhe Aktgjykimit [Rev.E.nr.20/2009] të 17 marsit 2010, respektivisht; Aktvendimit [IV.C.nr.1/2010] të 12 majit 2010 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut; dhe Aktvendimit [I.EK.nr.424/14] të 2 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore. Gjykata theksoi se përkundër dallimeve të caktuara në tri procedurat e ndjekura kontestimore, çështja para Gjykatës së Apelit, nuk kishte kufizime ad personam dhe as të fushëveprimit material, përkatësisht të gjitha procedurat civile kishin të bënin saktësisht me të njëjtat marrëdhënie juridike dhe të njëjtat rrethana e të cilat ishin thelbësore për vendosjen e kontestit përkatës. Ndërsa, përkitazi me çështjen e dytë, Gjykata gjithashtu konstatoi se në rrethanat e rastit konkret, rihapja e këtyre procedurave

nuk ishte e justifikuar nga rrethana të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*". Në këtë kontekst, Gjykata theksoi se arsyetimi i Gjykatës së Apelit, përmes Aktvendimit të kontestuar, se zhvillimi i një procedure penale paralelisht me procedurën kontestimore e pengonte kualifikimin e çështjes përkatëse civile si *res judicata*, duke theksuar se "*deri më tani nuk dihet epilogu i kësaj procedure penale",* është i pasaktë sepse deri në momentin kur Gjykata e Apelit kishte nxjerrë Aktvendimin e kontestuar, e tërë procedura penale kishte përfunduar përmes dy Aktgjykimeve në procedurë penale e të cilat kishin liruar të akuzuarit, përkatësisht punëtorët e Bankës nga përgjegjësia penale, të cilën "Nita Commerc" dhe Prokuroria përkatëse pretendonin se mbanin.

134. Prandaj dhe përfundimisht, Gjykata konstatoi se rihapja e procedurave gjyqësore të cilat kishin përfunduar përmes vendimeve të formës së prerë dhe për më tepër ishin ekzekutuar, në rrethanat e rastit konkret, nuk ishte e justifikuar përmes rrethanave të një "*karakteri substancial bindës dhe detyrues*" dhe rrjedhimisht, në nxjerrjen e Aktvendimit [Ae.nr.287/18] të 27 majit 2019 dhe Aktvendimit [I.EK.nr.330/19] të 1 gushtit 2019, Gjykata e Apelit dhe ajo Themelore, respektivisht, kishin vepruar në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike të mishëruar në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe për pasojë, të njëjtat Aktvendime u shpallën të pavlefshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, neneve 20, 21 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 maj 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi [VIII.C.Nr.207/06] i 23 nëntorit 2006 i Gjykatës Ekonomike të Qarkut, është përfundimtar dhe i detyrueshëm, dhe si i tillë *res judicata;*

IV. TË KONSTATOJË se Aktvendimi [Ae.nr.287/18] i 27 majit 2019 i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi [I.EK.nr.330/19] i 1

gushtit 2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë janë të pavlefshëm;

V. TË URDHËROJË gjykatat e rregullta që të ndërprejnë të gjitha procedurat në këtë çështje kontestimore në pajtim me këtë Aktgjykim;

VI. TË URDHËROJË Gjykatën e Apelit që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më datën 5 gusht 2021, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;

VII. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;

VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

IX. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI51/19, Parashtrues i kërkesës: Qamil Lupçi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ. UZVP. nr. 37/2018 të 5 dhjetorit 2018

KI51/19, Aktgjykim i miratuar më 28 prill 2021, publikuar më 7 qershor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përmbarim i vendimit të formës së prerë*

Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Komisionit të Ankesave të MPMS-së dhe kërkoi që t'i paguhen tri paga pas daljes në pension dhe një pagë si shpërblim jubilar ashtu siç parasheh neni 52 dhe neni 53 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës i 18 marsit 2014. Parashtruesi i kërkesës kishte pohuar se si paraqitës i kërkesës i ka plotësuar kushtet për pensionim dhe ka mbi dhjetë vjet përvojë pune pandërprerë në MPMS dhe se kërkesa e tij është e bazuar. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk pranoi ndonjë përgjigje nga Komisioni i Ankesave i MPMS-së lidhur me kërkesën e tij. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës (KMPSHCK) kishte theksuar se Komisioni i Ankesave i MPMS-së është i obliguar për shqyrtimin e ankesës së parashtruesit të kërkesës dhe nxjerrjen e vendimit meritor në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil. Herën e dytë, Komisioni i Ankesave i MPMS-së kishte konstatuar se nuk ka kompetencë lëndore për ta vlerësuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Ndërkohë, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi administrative për realizmin e kërkesës së tij, mirëpo, gjykatat e rregullta kishin konstatuar se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të zgjidhet në merita porse nuk kishin urdhëruar Komisionin e Ankesave të MPMS-së që të nxjerrë vendim meritor përkitazi me kërkesën e parashtruesit të kërkesës.

Gjykata vlerësoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me qasjen në gjykatë, si një ndër garancitë e përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, duke mbështetur këtë vlerësim në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ). Gjykata shtjelloi parimet e përgjithshme që burojnë nga GJEDNJ-ja dhe praktika e saj gjyqësore përkitazi me të drejtën për përmbarim të vendimit të formës së prerë.

Gjykata vlerësoi: (i) zbatimi i një vendimi të formës së prerë dhe të detyrueshëm, brenda një afati të arsyeshëm, është e drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së; (ii) mosmarrëveshja e parashtruesit me Komisionin e Ankesave të MPMS-së nuk ka qenë posaçërisht e ndërlikuar, sepse KPMSHCK-ja kishte urdhëruar nxjerrjen e një vendimi meritor që do t'i adresonte pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shpërblimin jubilar dhe pagesën e tri (3) pagave

përcjellëse, në pajtim me ligjin në fuqi; (iii) Vendimi i KPMSHCK-së ka mbetur i pazbatuar nga Komisioni i Ankesave i MPMS-së edhe sot e kësaj dite.

Gjykata përfundoi se do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi juridik i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim i formës së prerë në procedurë administrative dhe i përmbarueshëm, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Prandaj, joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat sjellin para situatave që janë në shpërputhje me parimin e sundimit të ligjit (neni 7 i Kushtetutës) – parim ky të cilin të gjitha autoritetet publike në Kosovë janë të detyruara ta respektojnë.

Gjykata konstatoi se moszbatimi i Vendimit të KPMSHCK-së nga Komisioni i Ankesave të MPMS-së ka rezultuar me shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI51/19

Parashtrues

Qamil Lupçi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, [A/02/68/2016] të 12 prillit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Qamil Lupçi, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [ARJ. UZVP. nr. 37/2018] të 5 dhjetorit 2018 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [AA. nr. 97/2018] të 10 tetorit 2018 të dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [A. Nr. 724/16] e 6 shtatorit 2017 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

3. Parashtruesi i kërkesës po ashtu konteston: (i) kushtetutshmërinë e Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë:

Komisioni i Ankesave të MPMS-së), nr. 2379 të 5 majit 2016, me ç 'rast parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar realizimin e të drejtave të garantuara me nenet 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të 18 marsit 2014; dhe, (ii) Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMSHCK) [A/02/68/2016] të 12 prillit 2016, me të cilin ishte urdhëruar Komisioni i Ankesave të MPMS-së që të nxjerrë vendim meritor lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë i Vendimit të Komisionit të Ankesave të MPMS-së, Vendimit të KPMSHCK-së dhe të vendimeve të gjykatave të rregullta, përmes së cilëve pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ*)* dhe nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës së Republikë së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 27 mars 2019, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 2 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).

8. Më 23 korrik 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrim të kërkesës dhe një kopje iu dërgua Gjykatës Supreme të Kosovës.

9. Më 25 shtator 2019, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të sqarojë disa aspekte të kërkesës së tij.

10. Më 25 shtator 2019, Gjykata kërkoi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS) që të njoftohet nëse Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave brenda MPMS-së ka zbatuar vendimin e KPMSHCK-së. MPMS-ja nuk iu përgjigj kërkesës së Gjykatës.

11. Më 25 shtator 2019, Gjykata kërkoi nga KPMSHCK-ja që të njoftohet nëse Komisioni i Ankesave i MPMS-së e ka zbatuar vendimin e KPMSHCK-së. KPMSHCK-ja nuk iu përgjigj kërkesës së Gjykatës.

12. Më 4 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument shtesë me sqarimet e kërkuara nga Gjykata.

13. Më 30 shtator 2020, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen ta shtyjë për një seancë tjetër në përputhje me plotësimet e kërkuara.

14. Më 6 tetor 2020, nga MPMS-ja u kërkua që të dorëzon dokumente shtesë lidhur me pretendimet e ngritura në kërkesën nr. KI51/19.

15. Më 8 tetor 2020, MPMS-ja dorëzoi dokumente shtesë që ndërlidhen me pretendimet e ngritura në kërkesën nr. KI51/19. MPMS-ja dorëzoi: (i) Vendimin e Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, nr. 389, të 7 dhjetorit 2015; (ii) Vendim i KPMSHCK-së, A 02/68/2016, i 12 prillit 2016; (iii) Vendim i KPMSHCK-së, A/02/64/2016, i 14 prillit 2016; (iv) Referencë nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MPMS-së, nr. 2097, e 15 prillit 2016; (v) Vendim i Komisionit të Ankesave të MPMS-së, nr. 2379, të 5 majit 2016.

16. Më 25 mars 2021, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen ta shtyjë për një seancë tjetër në përputhje me plotësimet e kërkuara.

17. Më 28 prill 2021, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

18. Në të njëjtën ditë, Gjykata konstatoi: (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

Përmbledhja e fakteve

19. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se parashtruesi i kërkesës ka punuar si shërbyes civil (pozita: inspektor i punës) në MPMS.

20. Më 7 dhjetor 2015, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në MPMS me Vendim të protokolluar me nr. 389 vendosi: (i) parashtruesi i kërkesës (Qamil Lupçi) në vendin e punës Inspektor i punës në kuadër të Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës/MPMS, i përfundon marrëdhënia e punës më datë 11 dhjetor 2015; (ii) të përmendurit marrëdhënia e punës i përfundon për shkak të arritjes së moshës së pensionimit gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MPMS-së arsyetoi se bazuar në dokumentet e dosjes personale, parashtruesi i kërkesës ka lindur më 10 dhjetor 1950, se në bazë të dëshmive ka arritur moshën mandatore për pensionim më 10 dhjetor 2015, kurse në mbështetje të akteve ligjore dhe nën-ligjore në fuqi atij i përfundon marrëdhënia e punës më 11 dhjetor 2015. Vendimi i lartpërmendur përmbante këshillë juridike që përcakton: *"Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë në ankesë në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të vendimit dhe drejtohet për komisionin për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave të MPMS-së."*

21. Vendimi i lartpërmendur i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MPMS-së është i heshtur lidhur me të drejtën e parashtruesit të kërkesës që t'i paguhen tri paga pas daljes në pension dhe një pagë si shpërblim jubilar ashtu siç parasheh neni 52 dhe neni 53 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës i 18 marsit 2014, edhe pse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka qenë në fuqi në kohën e marrjes së vendimit të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MPMS-së.

22. Më 14 janar 2016, parashtruesi i kërkesës përmes kërkesës nr. 24 iu drejtua Komisionit të Ankesave të MPMS-së dhe kërkoi që t'i paguhen tri paga pas daljes në pension dhe një pagë si shpërblim jubilar ashtu siç parasheh neni 52 dhe neni 53 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës i 18 marsit 2014. Parashtruesi i kërkesës kishte pohuar se si paraqitës i kërkesës i ka plotësuar kushtet për pensionim dhe ka mbi dhjetë vjet përvojë pune pandërprerë në MPMS dhe se

kërkesa e tij është e bazuar. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk pranoi ndonjë përgjigje nga Komisioni i Ankesave i MPMS-së lidhur me kërkesën e tij.

23. Më 24 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në KPMSHCK për shkak të heshtjes administrative të Komisionit të Ankesave të MPMS-së lidhur me kërkesën e tij. Ndër të tjera, parashtruesi i kërkesës kërkoi tri paga pas daljes në pension dhe një pagë si shpërblim jubilar.

24. Më 12 prill 2016, KPMSHCK-ja përmes Vendimit [A/02/68/2016] detyroi Komisionin e Ankesave që të shqyrtojë ankesën e parashtruesit të kërkesës ashtu siç përcaktohet me nenin 82 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

25. Ndër të tjera, KPMSHCK-ja kishte sqaruar si në vijim:

> *"Kolegji për shqyrtimin e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke obliguar organin e punësimit, gjegjësisht Sekretarin e Përgjithshëm dhe Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, që ti ndërmarr të gjitha veprimet, për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 14.01.2016 me numër 24. Në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil, organet e punësimit janë të obliguara të themelojnë Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për të shqyrtuar çdo ankese që paraqitet nga nëpunësit civil dhe aplikuesit për punësim në shërbimin civil, ashtu siç parashihet me nenin 82 paragrafin 1 dhe 2 te Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës se Kosovës, ku përcaktohet se "Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave themelohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e kontesteve dhe pranimin e ankesave. Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe te ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës."*

26. Në vendimin e lartpërmendur, KPMSHCK-ja po ashtu kishte theksuar se Komisioni i Ankesave i MPMS-së është i obliguar për shqyrtimin e ankesës dhe nxjerrjen e **vendimit meritor** në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil.

27. Më 5 maj 2016, Komisioni i Ankesave në MPMS me Vendim nr. 2379 përcaktoi: (i) Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës për pagesën e shpërblimit jubilar dhe kompensimin e pagës përcjellëse në lartësi prej 3 pagave mujore që i ka marrë për tre muajt e fundit; (ii) Rekomandohet që kërkesa të ndjek procedurën administrative dhe t'i drejtohet udhëheqësit më të lartë administrativ të organit të punësimit. Komisioni i Ankesave të MPMS-së arsyetoi: (i) Komisioni i Ankesave së MPMS-së bazuar në legjislacionin në fuqi vlerëson **jo-kompetencë lëndore** për të vendosur për kërkesën e parashtruesit të kërkesës; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk atakon kurrfarë vendimi me të cilin pretendohet që i janë shkelur të drejtat e tij ligjore; (iii) parashtruesi i kërkesës nuk ka drejtuar asnjë kërkesë për kompensimin në fjalë, organit të punësimit; (iv) rekomandohet parashtruesi i kërkesës t'i ndjek procedurat përkatëse administrative për realizimin e të drejtave të tij ligjore.

28. Në vendimin e lartpërmendur të Komisioni i Ankesave të MPMS-së kishte dhënë këshillë juridike që përcakton: *"Kundër këtij vendimi pala ka të drejtë të ushtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda afatit 30 ditor nga dita e marrjes së këtij Vendimi."* .

29. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore duke kërkuar që (i) të detyrohet MPMS-ja t'ia njeh kompensimin e tri pagave mujore përcjellëse për shkak të pensionimit dhe një pagë si shpërblim jubilar; si dhe, (ii) anulimin e vendimit të KPMSHCK-së [nr.AO2/68/2016] të 12 prillit 2016, pasi që kjo e fundit nuk vendosi në merita për ankesën e parashtruesit të kërkesës por e delegoi zgjidhjen e ankesës së tij në Komisionin e Ankesave të MPMS-së.

30. Më 6 shtator 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [A.nr724/2016] refuzoi të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës për anulimin e Vendimit të KPMSHCK-së [nr.AO2/68/2016] të 12 prillit 2016. Si arsye për refuzim të kërkesëpadisë, Gjykata Themelore, ndër të tjera, theksoi se KPMSHCK-ja ka vepruar drejtë kur me Vendimin kontestues [nr.AO2/68/2016] të 12 prillit 2016 ka obliguar Komisionin e Ankesave të MPMS-së që brenda 15 ditëve të vendos në lidhje me ankesën e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore nuk i aprovoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e pagave me arsyetimin se vendimi i KPMSHCK-së duhet të zbatohet nga organi administrativ i shkallës së parë.

31. Në aktgjykimin e lartpërmendur, Gjykata Themelore kishte konstatuar:

> "*Gjykata konstaton se e paditura Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka aplikuar drejt dispozitat ligjore dhe ka vepruar drejt kur me vendimin nr. A02/68/2016 të datës 12.04.2016 ka obliguar Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MPMS që në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ta shqyrtoj ankesën e paditësit dt. 14.01.2016. Gjykata pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues kur organit të punësimit i behet me dije se ligjërisht janë të obliguara të themelojnë Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave për të shqyrtoj çdo ankesë që paraqitet nga nëpunësit civil dhe aplikuesit për punësim në shërbimin civil, obligim ky që parashihet me dispozitën e nenit 82 te Ligjit nr.03/L149 për Shërbimin Civil të Kosovës. Gjykata nuk i aprovoi pretendimet e paditësit kërkesën për kompensimin për pagesën e shpërblimit jubilar dhe pagesave për përcjellëse në pension, sepse ne ketë faze të procedurës se konfliktit administrativ gjykata konsideron se vendimi kontestues i Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet te zbatohet nga organi administrativ i shkalles së parë sipas rekomandimeve të dhëna në vendimin N02/68/2016 datës 12.04.2016 [...] Gjykata nuk i aprovoi pretendimet e paditësit kërkesën për kompensimin e pagesën e shpërblimit jubilar dhe pagesave përcjellëse në pension, sepse në këtë fazë të konfliktit administrativ gjykata konsideron se vendimi kontestues i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të zbatohet nga organi administrativ i shkallës së parë sipas rekomandimeve të dhëna në vendimin A/02/68/2016 datës 12.04.2016.*"

32. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me qëllim që aktgjykimi i kontestuar të ndryshohet dhe rasti të kthehet në rigjykim. Njëkohësisht, parashtruesi i kërkesës kërkoi që të obligohet MPMS-ja t'ia paguajë pagat pas daljes në pension.

33. Më 10 tetor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.97/2018] refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore

[A.nr724/2016], të 6 shtatorit 2017. Gjykata e Apelit arsyetoi se Gjykata Themelore kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesë në mënyrë të drejtë dhe pa shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konflikt Administrativ.

34. Në Aktgjykimin e lartpërmendur, Gjykata e Apelit kishte arsyetuar:

"Sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes pa kurrfarë baze ligjore ka konstatuar se KPMSHCK, me vendimin Al02/68/2016 të datës 12.04.2016, ka vepruar drejtë duke u thirrur në nenin 82 të Ligjit Nr.031L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ngase kjo dispozitë ligjore nuk ka pasur fare nevojë të citohet, sepse me të njëjtën parashihet se organet e punësimit janë të obliguara që të themelojnë Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ndërsa në MPMS komisioni ka ekzistuar kur është paraqitur kërkesa nr.24 e datës 14.01.2015, dhe ekziston edhe sot [...].

Pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë pasi që ka vlerësuar se duhet pritur organin e punësimit për të vendosë lidhur me kërkesën[...] është dashur që ta ndërpresë derisa të vendoset kërkesa në fjalë si çështje paraprake duke zbatuar dispozitën ligjore nga neni 32 të Ligjit Nr. 03/L020 për Konfliktet Administrative, me të cilën përcaktohet se "Kur vendimi i gjykatës në konfliktin administrativ varet nga çështja juridike e cila përbën tërësi të mëvetësishme juridike, e mbi të cilën gjykata tjetër ose organi tjetër nuk ka vendosur (çështja paraprake), gjykata që zhvillon konfliktin administrativ, mund të vendosë atë çështje, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ose mund ta ndërpresë procedurën deri në nxjerrjen e vendimit mbi çështjen paraprake, nga ana e organit kompetent". Këto pretendime ankimore ky kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pabazuara dhe paargumentuara, për t'u aprovuar ankesa. Sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkalles së parë drejtë ka vendosur kur ka refuzuar si të pa bazuara pretendimet e paditësit të dhëna në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, kjo për faktin se në këtë fazë të procedurës së konfliktit administrativ, vendimi kontestues i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër A02/68/20 16 të datës 12.04.2016, duhet të zbatohet nga organi administrativ i shkallës së parë sipas rekomandimeve të dhëna në to."

35. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të

vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të se drejtës materiale dhe shkelje të dispozitave procedurale si dhe të anulohen vendimet e lartpërmendura të gjykatave të instancës më të ulët dhe çështja të kthehet në rivendosje.

36. Më 5 dhjetor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ.UZVP.NR.67/2018] refuzoi të pabazuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.97/2018 të 10 tetorit 2018.

37. Në Aktgjykimin e lartpërmendur, Gjykata Supreme kishte shpjeguar:

"Sipas nenit 82 të Ligjit nr.03/L-149 për shërbimin civil, parashihet se Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave themelohen në kuadër te çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e kontesteve dhe pranimin e ankesave. Në par.2 të këtij neni thuhet se vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës. Nga shkresat e lëndës rezulton se organi administrativ -Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave të MPMS nuk ka nxjerrë vendim ligjor sipas ankesës së paditësit nr.24 datë 14.01.2016, dhe se i padituri KPMSHCK ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore, nenin 82 par.1 dhe 2, dhe ka vepruar drejtë kur me vendimin ka obliguar Komisionin ta shqyrtoj ankesën e paditësit nr.24 dt. 14.01.2016. Ligjërisht është i obliguar organi administrativ-Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave të MPMS për të vepruar sipas vendimit te KPMSHCK, dhe më pas e drejta për të paraqitur ankesë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [ARJ.UZVP.NR.67/2018] i 5 dhjetorit 2018 dhe Vendimi i KPMSHCK-së [A/02/68/2016] i 12 prillit 2016 shkelin të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

39. Parashtruesi i kërkesës pohon se që nga paraqitja e kërkesës në Komisionin e Ankesave të MPMS-së dhe pas kalimit të afatit 15 ditësh

të vendosur nga KPMSHCK-ja, ai nuk ka pranuar ndonjë përgjigje në lidhje me kërkesën e tij nga Komisioni i Ankesave i MPMS-së. Sipas tij, që nga koha e pensionimit parashtruesi i kërkesës është duke ndërmarrë veprime juridike për ta realizuar të drejtën e tij, andaj ai pretendon se ka pritje legjitime në realizimin e kërkesës së tij.

40. Në të njëjtën kohë, parashtruesi i kërkesës pretendon se KPMSHCK-ja kishte dështuar po ashtu që të zgjidhte rastin e tij. Sipas tij, neni 12 i Ligjit Nr. 03/l-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i jep të drejtë KPMSHCK-së që të vendos lidhur me ankesën e shërbyesit civil, nëse në mënyre të arsyeshme beson se organi i punësimit do të dështojë që të zgjidhë ankesën brenda 30 ditëve.

41. Parashtruesi i kërkesës specifikisht pretendon: *"Dispozita e nenit 12, paragrafi 3, nënpargrafi 3.1 1 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarure Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i jep të drejtë Këshillit në fjale të vendose lidhure me ankesën e shërbyesit civil, nëse në mënyre të arsyeshme beson se do të dështoj organi i punësimit për të zgjedh ankesën brenda 30 ditëve. Pra përkundër faktit se KPMSHCK, ka pas dëshmi bindëse se organi i punësimit nuk do ta zgjedh ankesën në fjalë asnjëherë - pra ka dështuar, me vendimin A/02/68/2016 te dt. 12.04.2016, pa kurrfarë baze dhe arsyeje të njëjtit organ ia ka kthyer përsëri ankesën në fjalë. Vendimi i KPMSHCK A/02/68/2016 te dt. 12.04.2016, nuk ka kurrfarë efekti sepse edhe pse kane kaluar me tepër se 3 vjet, paraqitësi i kërkesës nuk ka marre ndonjë përgjigje për zbatimin e tij. Ndërsa KPMSHCK, nuk ka ndërmarre asnjë veprim për zbatimin e vendimit në fjalë".*

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Nëse në rastin konkret detyrimisht duhet pritur Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në MPMS, Gjykata ka mundur ta ndërpresë dhe ti jepet edhe një afat Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në MPMS, por jo padia të refuzohet në këtë mënyrë*".

43. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që t'i shpallë të pavlefshme vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta dhe vendimin e KPMSHCK-së dhe një gjykim të drejtë ku do të rezultonte: "*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të mi paguaj 1.700.00 euro në emër të tri pagave mujore me rastin e pensionimit dhe një pagë prej 569.00 euro në emër të pagës jubilare, që gjithsej bëjnë 2.276.00 euro, shpenzimet procedurale në shumë 120.00 euro, me kamatë 8% duke llogaritur prej 14.01.2016, në bazë të neneve 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës*".

44. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës "*shprehë dëshirën për të marrë pjesë në seancën gjyqësore*".

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
(...)
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
(...)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
(...)
3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtm

d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të

dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

E DREJTA E PRONES NENI 46
(...)

Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës Së Kosovës

Neni 81
Organet për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave

1. *Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë.*

2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe:

2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe

2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës.

Neni 82
Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave

1. Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave themelohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e kontesteve dhe pranimin e ankesave.

2. Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës.

3. Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë nga radhët e nëpunësve civilë, me përgatitje superiore shkollore, emërohen nga Sekretari i Përgjithshëm apo nga pozitat ekuivalente të institucioneve përkatëse në periudhë dy (2) vjeçare, me mundësi vazhdimi, dhe

pasqyrojnë diversitetin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë sidomos diversitetin gjinor.

4. Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit të kontesteve dhe të ankesave nuk mund të shërbejnë si anëtarë të komisionit disiplinor të institucionit përkatës.

*5. Kriteret për emërimin e anëtarëve, kompetencat dhe procedurat e komisionit për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve nga marrëdhënia e punës, përcaktohen me akt nënligj*or.

Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Neni 12
Ankesat

1.Nëpunësi civil i cili është i pa kënaqur me vendim të organit të punësimit, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, ka të drejtë të ankohet në Këshill.

2. Në emër të Këshillit ankesat i shqyrton dhe i vendos kolegji i përbërë nga tre (3) anëtarë të Këshillit.

3. Rregullat dhe procedurat për ankesa sipas këtij neni caktohen nga Këshilli. të cilat përcaktojnë:

3.1. që para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave të organit përkatës të punësimit, përveç nëse Këshilli e përjashton këtë kërkesë për shkak të frikës së arsyeshme të hakmarrjes, dështimit të organit të punësimit për të zgjidhur ankesën brenda tridhjetë (30) ditësh ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm;

3.2. që pala e dëmtuar dhe organi i punësimit të kenë mundësi t'ia paraqesin me shkrim qëndrimet e tyre Këshillit, të cilat duhet t'i vihen në dispozicion palës kundërshtuese;

3.3. që në rastet e kontesteve të fakteve materiale, të dy palëve t'u jepet mundësia që së bashku të merren në pyetje nga Këshillit, ku ata mund t'i paraqesin provat dhe dëshmitë gjatë marrjes në pyetje dhe hetimit;

3.4. që për çdo ankesë që paraqitet para tij, Këshilli brenda afatit prej (60) ditësh pas përfundimit të procedurës së ankesës duhet të lëshojë një vendim me shkrim, duke arsyetuar vendimin e tij dhe bazën ligjore e faktike të atij vendimi.

3.5. përjashtim nga nën-paragrafi 3.4 i këtij paragrafi mund të ketë në rast kur natyra e lëndës është specifike për të cilin këshilli nxjerr vendim dhe afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh mund ti shtohen edhe tridhjetë (30) ditë.

4. Në rastet kur Këshilli bindet se përmes vendimit të kundërshtuar janë shkelur parimet apo rregullat e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, ai nxjerr vendim me shkrim i cili i drejtohet zyrtarit të nivelit të lartë drejtues apo përgjegjësit kryesor të organit përkatës të punësimit, i cili është përgjegjës për zbatimin vendimit të Këshillit

5. Anëtari i Këshillit i cili ka marrë pjesë si anëtar i komisionit përkitazi me emërimin e një nëpunësi civil, nuk mund të marrë pjesë në procedurën e ankesës ndaj vendimit të tillë.

Neni 13
Vendimi i Këshillit

Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 15
Procedura në rast moszbatimi të vendimit të Këshillit

1. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Ligji i Punës Nr.03/L-212

Neni 90
Marrëveshja Kolektive

1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:

1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe

1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve;

2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:

2.1. nivel të vendit,

2.2. nivel të degës,

2.3. nivel të ndërmarrjes.

3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet.

5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive.

6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj.

7. Punëdhënësi u'a vë në dispozicion të punësuarve një kopje të Marrëveshjes Kolektive.
8. Marrëveshja Kolektive regjistrohet në Ministri, në pajtim me kushtet dhe kriteret e paracaktuar me aktin nënligjor.

9. Për zgjidhjen e kontesteve të ndryshme në mënyrë paqësore dhe zhvillimin e konsultave nga fusha e punësimit, mirëqenies sociale dhe politikave ekonomike të punës nga përfaqësuesit punëdhënësve, punëmarrësve dhe Qeverisë në cilësi të partnerëve social me akt te veçantë ligjor-nënligjor themelohet Këshilli Ekonomiko Social.

10. Çështjet e tjera të dialogut social rregullohen me akt ligjor ose nënligjor, varësisht nga marrëveshja e arriturnga partnerët social.

Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e 18 marsit 2014

Neni 52
Shpërblime jubilare

1. I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë:

1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij;

1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij;

1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij.

2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilare.

3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.

Neni 53
Kompensimi në rast të pensionimit

I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt të fundit.

Vlerësimi i pranueshmërisë se kërkesës

45. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuar me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

46. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, që përcaktojnë:

> *"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

47. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç parashikohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashikojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. "*Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

2. *Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]."

48. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [ARJ.UZVP.nr.67/2018] të 5 dhjetorit 2018, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë

shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

49. Prandaj, Gjykata vjen në përfundim se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike; se e ka respektuar kushtin e dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor; i ka sqaruar me saktësi shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe ka treguar cili është akti konkret i autoritetit publik që kontestohet.

50. Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze kushtetuese dhe përcaktimi i tyre varet nga shqyrtimi i meritave të kërkesës. Po ashtu, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme (shih Gjykata Kushtetuese Rasti nr. KI97/16, *Parashtrues IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017).

51. Rrjedhimisht, Gjykata shpall kërkesën të pranueshme.

Meritat e kërkesës

52. Gjykata rikujton se në substancë pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës është shkelja e të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, sepse Komisioni i Ankesave i MPMS-së kishte dështuar dy herë që t'i përgjigjet kërkesës së parashtruesit të kërkesës lidhur me pagesën e tri pagave pas pensionimit dhe një pagë shpërblim jubilar ashtu siç parashikojnë neni 52 dhe 53 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës të 18 marsit 2014.

53. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës në thelb pohon se edhe KPMSHCK-ja kishte dështuar që të zgjidh rastin e tij sepse nuk kishte vendosur në merita por kishte zgjedhur që ta detyrojë Komisionin e Ankesave të MPMS-së që t'i përgjigjet ankesës së parashtruesit të kërkesës.

54. Gjykata i referohet dispozitave përkatëse të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së:

> Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) i KEDNJ-së:

"Çdo person ka të drejte që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendose si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për besueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjate tere procesit ose gjate një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtar në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallen që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur ne rrethana te veçanta publiciteti do te dëmtonte interesat e drejtësisë."

55. Gjykata gjithashtu përsërit se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për te Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *"[Te drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me ketë Kushtetute, interpretohen ne harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut]".*

56. Në këtë drejtim, Gjykata se pari vëren se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së vazhdimisht konsideron se drejtësia e procedurës vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih rastin e GJEDNJ-së, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, nr. 146, paragrafi 68). Prandaj, në procedurën e vlerësimit të bazës se pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'u përmbahet këtyre parimeve.

57. Gjykata thekson se në praktikën e saj gjyqësore në shumë raste ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe

zbatimit të ligjit janë brenda fushëveprimit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë antikushtetuese (shih, mes tjerash, Gjykata Kushtetuese Rasti nr. KI33/16, Parashtruese *Minire Zeka*, Aktgjykim i 4 gushtit 2018, paragrafi 91).

58. Ngjashmërisht, roli i Gjykatës në kërkesën individuale konkrete të dorëzuar në kuadër të nenit 113.7 është i karakterit subsidiar karshi Komisionit të Ankesave të MPMS-së, KPMSHCK-së dhe gjykatave të rregullta, mirëpo, vendimi i fundit nëse kufizimi i të drejtës për qasje në gjykatë të parashtruesit të kërkesës është në pajtim me Kushtetutën, KEDNJ-në, megjithatë, merret nga Gjykata.

59. Gjykata verën se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës është shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Komisioni i Ankesave i MPMS-së dhe KPMSHCK-ja kanë pasur detyrim ligjor për t'iu përgjigjur dhe zgjidhur ankesat e parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi më tej pretendon se Komisioni i Ankesave i MPMS-së dhe KPMSHCK-ja me këtë mosveprim e kanë privuar atë nga e drejta për një gjykim të drejtë.

60. Gjykata vëren se parashtruesi i paraqiti këto pretendime në gjykatat e rregullta, të cilat refuzuan kërkesën e tij si të papranueshme. Ndërsa, KPMSHCK-ja nuk vendosi në merita për ankesën e parashtruesit por detyroi Komisionin e Ankesave të MPMS-së që të shqyrtojë në merita kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Komisioni i Ankesave, pas vendimit të KPMSHCK-së, nxori një vendim procedural që nuk trajtonte në substancë kërkesën e parashtruesit të kërkesës lidhur me shpërblimin jubilar dhe pagesën e tri (3) pagave përcjellëse.

61. Në rastin konkret, parashtruesi konsideron se Vendimi i KPMSHCK-së [A/02/68/2016] i 12 prillit 2016 dhe aktgjykimet e gjykatave të rregullta, specifikisht Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [ARJ-UZVP.NR 66/2018] i 5 dhjetorit 2018, kanë shkelur të drejtën për gjykim të drejtë, me arsyetimin se "*Ligji Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrëse për Shërbimin Civil të Kosovës i jep te drejtë KPMK-së që të vendos lidhur me ankesën e shërbyesit civil, nëse në mënyre të arsyeshme besojnë se do të dështoj organi i punësimit për të zgjedhe ankesën brenda 30 ditëve. Pra, përkundër faktit se KPMK-ja, ka pas dëshmi bindëse se organi i punësimit nuk do ta zgjedh ankesën në fjalë asnjëherë, me vendimi [A/02/68/2016] të 12 prillit 2016, pa*

kurrfarë baze dhe arsyeje të njëjtit organ ia ka kthyer përsëri ankesën në fjalë. Vendimi i KPMK-së [A/02/68/2016] i 12 prillit 2016 nuk arriti kurrfarë efekti, sepse edhe pse kane kaluar me tepër se tre vjet, paraqitësi i kërkesës nuk ka marr ndonjë përgjigje për zbatimin e tij".

62. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pohon se edhe pas vendimit të KPMSHCK-së për të obliguar Komisionin e Ankesave të MPMS-së që të vendosë lidhur me kërkesën e tij, ai nuk kishte pranuar përgjigje nga ky i fundit lidhur me ankesën e tij. Gjykata vëren se në thelb, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë, pasi që nuk arriti të marrë përgjigje nga Komisioni i Ankesave i MPMS-së, KPMSHCK-ja dhe gjykatat e rregullta e refuzuan ankesën e tij pa e shqyrtuar thelbin e saj.

63. Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka marrë përgjigje në merita ndaj pretendimeve të tij për pagesën e tri pagave të pensionimit dhe shpërblimit jubilar nga Komisioni i Ankesave i MPMS-së dhe që në fazat e mëvonshme në procedurat e zhvilluara në KPMSHCK dhe gjykatat e rregullta, pozita e parashtruesit ka mbetur e pandryshuar, d.m.th., ai nuk ka marrë përgjigje në merita apo në substancë ndaj pretendimeve të tij.

64. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston vendimin e KPMSHCK-së, vendimet e Komisionit të Ankesave të MPMS-së si dhe të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta. Mirëpo, pavarësisht pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vlerëson se në rastin konkret bëhet fjalë për moszbatim të vendimit të KPMSHCK-së në dobi të parashtruesit të kërkesës, prandaj, vlerësimi kushtetues i mëposhtëm trajton vetëm çështjen e moszbatimit të vendimit të formës së prerë përkatësisht Vendimit të KPMSHCK-së [A/02/68/2016] të 12 prillit 2016, siç është vërtetuar me vendimet e gjykatave të rregullta.

65. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se duke qenë zotëruese e karakterizimit të fakteve të rastit, nuk e konsideron vetveten të lidhur nga karakterizimi i dhënë nga parashtruesi i kërkesës. Në frymën e parimit *juria novit curia,* Gjykata me vullnetin e vet mund të shqyrtojë ankesat duke u mbështetur në dispozita ose paragrafë në të cilat nuk janë thirrur shprehimisht palët. Në ndërlidhje me këtë, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, një ankesë karakterizohet nga faktet që përmban ajo dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet e referuara shprehimisht në të nga palët (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI193/18, *Parashtrues Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020, paragrafi 116; dhe po ashtu shih, *mutatis mutandis,*

rastin e GJEDNJ-së *Talpis kundër Italisë,* Aktgjykim i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e përmendura aty).

(i) Lidhur me efektin e vendimeve të KPMSHCK-së

66. Përkitazi me natyrën juridike të vendimeve të KPMSHCK-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme që t'i referohet nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës, që përcakton:

> *"1. Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.*
>
> *2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës."*

67. Duke marrë parasysh këto dispozita ligjore, Gjykata thekson qëndrimin e saj parimor se KPMSHCK-ja është institucion i pavarur i themeluar me Kushtetutë, gjegjësisht në pajtim me nenin 101. 2 të Kushtetutës. Prandaj, të gjitha detyrimet që dalin nga vendimet e këtij institucioni, lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e tij, prodhojnë efekte juridike për të gjitha institucionet përkatëse, ku statusi i të punësuarve rregullohet me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim, KPMSHCKK-ja ka tiparet e një gjykate, gjegjësisht tribunali për shërbyesit civilë, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin nr. KI193/18, *Parashtrues Agron Vula*, cituar më lart, paragrafi 100).

68. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas të cilës *"'gjykata' karakterizohet në kuptimin thelbësor të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë vendosja e çështjeve brenda kompetencave të saj në bazë të rregullave të së drejtës dhe pas procedurave të kryera në mënyrë të paraparë* (Shih, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987 në çështjen *H kundër Belgjikës*, Seria A. nr. 127, f. 34, § 50; shih po ashtu rastin e GJEDNJ-së *Belilos kundër Zvicrës*, ankesë nr. 10328/83, Aktgjykimi i 29 prillit 1988, § 64).

69. Në këtë drejtim, Gjykata thekson qëndrimin e saj konsekuent që e ka mbajtur në të gjitha rastet e vendosura prej saj, që kanë pasur të bëjnë me vendimet e KPMSHCK-së, që nga viti 2012 e këndej. Gjykata në vazhdimësi ka vënë në pah se një vendim i KPMSHCK-së prodhon

efekte juridike për palët dhe, për këtë arsye, një vendim i tillë është vendim i formës së prerë në procedurë administrative dhe i përmbarueshëm (Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet KI193/18, cituar më lart; KI04/12 *Esat Kelmendi*, Aktgjykimi i 24 korrikut 2012 dhe nr. KI74/12, *Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 prillit 2015 dhe referencat e cituara aty).

70. Gjykata sjell në vëmendje se ndër rastet e para ku ishte konstatuar se vendimet e KMPSHCK-së janë të formës së prerë dhe të detyrueshme për përmbarim është Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI04/12, i 24 korrikut 2012. Në aktgjykimin në fjalë, Gjykata kishte trajtuar efektin e vendimit të KPMK-së të datës 18 mars 2011 – që do të thotë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për KPMK-në Nr.03/L-192, i cili më vonë, më datë 10 gusht 2018, u zëvendësua dhe u shfuqizua nga Ligji për KPMSHK-në nr. 06/L-048. Që të dyja ligjet në fjalë, janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (shih rastin KI193/18, *Parashtrues Agron Vula*, cituar më lart, paragrafi 104).

71. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore, përveç kompetencës lëndore të KPMSHCK-së për të zgjidhur mosmarrëveshjet e punës për nëpunësit civilë, paraqesin detyrim ligjor për institucionet gjegjëse për të respektuar dhe zbatuar vendimet e KPMSHCK-së (shih rastin KI193/18, *Parashtrues Agron Vula*, cituar më lart, paragrafi 105).

72. Në këtë vazhdë, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore edhe lidhur me mospërmbarimin nga ana e gjykatave të vendimeve administrative – duke përfshirë edhe vendimet e KPMSHCK-së – të cilat nuk kanë parashikuar në mënyrë ekskluzive një detyrim në të holla (Shih, ndër të tjera, vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet: KI193/18, *Parashtrues Agron Vula*, cituar më lart; KI94/13, *Parashtrues Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 16 prillit 2014; KI112/12, parashtrues *Adem Meta*, Aktgjykim i 2 gushtit 2018 dhe KI04/12, *Parashtrues Esat Kelmendi* , cituar më lart). Në këto raste, Gjykata erdhi në përfundim se "një vendim i nxjerrë nga një organ administrativ, i themeluar me ligj, prodhon efekte juridike për palët dhe, rrjedhimisht një vendim i tillë është një vendim administrativ i formës së prerë dhe i përmbarueshëm".

73. Veç kësaj, duke u mbështetur në shkresat e lëndës që ka dispozicion, Gjykata thekson posaçërisht faktin se gjykatat e rregullta në arsyetimet e tyre kanë përcaktuar se Vendimi i KPMSHCK-së [A/02/68/2016] i 12 prillit 2016 duhet të zbatohet nga Komisioni i Ankesave të MPMS-së.

74. Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga gjykatat e rregullta përkitazi me Vendimin e KPMSHCK-së [A/02/68/2016] i 12 prillit 2016, përcakton se vendimi në fjalë ka karakter detyrues që duhet të zbatohet nga Komisioni i Ankesave të MPMS-së.

75. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se vendimi i KPMSHCK-së në rastin konkret ka qenë i formës së prerë dhe i detyrueshëm për t'u ekzekutuar.

(ii) Përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

76. Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], që përcakton:

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."

77. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe paragrafit 1, të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, që parasheh:

> *"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme".*

78. Gjykata po ashtu i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, që përcakton:

"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

79. Në këtë sfond, Gjykata sjellë në vëmendje se Vendimi i KPMSHCK-së ka urdhëruar Komisionin e Ankesave të MPMS-së që të nxjerrë një vendim meritor lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shpërblimin jubilar dhe pagesën e tri (3) pagave përcjellëse.

80. Gjykata vë në pah pretendimin kryesor të parashtruesit, përkitazi me cenimin e të drejtës së tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet aktgjykimit të saj në rastin nr. KI94/13, ku kishte theksuar se "përmbarimi i vendimit të prerë dhe të përmbarueshëm duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin nr. KI94/13, *Parashtrues, Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj,* cituar më lart).

81. Gjykata vëren se një qëndrim i tillë mbështetet dhe në praktikën e GJEDNJ-së, e cila thekson se përmbarimi i një vendimi të formës së prerë duhet shikuar si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë. Për më tepër, në rastin *Hornsby kundër Greqisë*, GJEDNJ ka vënë në pah se përmbarimi i vendimit të formës së prerë është i një rëndësie edhe më të madhe në kuadër të procedurës administrative në lidhje me një kontest, rezultati i të cilit është i një rëndësie të posaçme për të drejtat civile të palës në kontest (shih rastin e GJEDNJ-së, *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, Aktgjykim i 19 marsit 1997, paragrafët 40-41). Në rastin në fjalë, GJEDNJ kishte përcaktuar se parashtruesit e kërkesës nuk do të duhej të ishin privuar nga përfitimi i përmbarimit të vendimit të formës së prerë, që ishte marrë në dobi të tyre.

82. Prandaj, Gjykata thekson se zbatimi i një vendimi të formës së prerë dhe të detyrueshëm, brenda një afati të arsyeshëm, është e drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

83. Në lidhje më këtë, Gjykata vëren se GJEDNJ-ja në praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore ka konstatuar se duke u shmangur për më shumë se 5 (pesë) vite për ndërmarrjen e masave të nevojshme për zbatim të një vendimi të formës së prerë dhe të detyrueshëm, autoritetet shtetërore kishin zhveshur dispozitat e nenit 6 nga tërë efekti i tyre i dobishëm (shih rastin e GJEDNJ-së, *Hornsby kundër Greqisë,* cituar më lart, paragrafi 45).

84. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se mosmarrëveshja e parashtruesit me Komisionin e Ankesave të MPMS-së nuk ka qenë posaçërisht e ndërlikuar, sepse KPMSHCK-ja kishte urdhëruar nxjerrjen e një vendimi meritor që do t'i adresonte pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shpërblimin jubilar dhe pagesën e tri (3) pagave përcjellëse, në pajtim me ligjin në fuqi. Vendimi i KPMSHCK-

së ka mbetur i pazbatuar nga Komisioni i Ankesave i MPMS-së edhe sot e kësaj dite.

85. Në ndërlidhje më këtë, Gjykata thekson se do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi juridik i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim i formës së prerë në procedurë administrative dhe i përmbarueshëm, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Prandaj, joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat sjellin para situatave që janë në shpërputhje me parimin e sundimit të ligjit (neni 7 i Kushtetutës) – parim ky të cilin të gjitha autoritetet publike në Kosovë janë të detyruara ta respektojnë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet nr. KI193/18 dhe KI04/12, të cituara më lart).

86. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se moszbatimi i Vendimit të KPMSHCK-së [A/02/68/2016], i 12 prillit 2016, nga Komisioni i Ankesave të MPMS-së ka rezultuar me shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

Kërkesa e parashtruesit për shqyrtim verbal

87. Sa i përket "dëshirës së shprehur" të parashtruesit të kërkesës për "pjesëmarrje në seancë", Gjykata i referohet nenit 20 [Vendimet] të Ligjit që parasheh:

"*1.Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.*

2.Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës."

88. Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur në këtë rast bazuar në dispozitën e nenit 20 paragrafit 2 të Ligjit (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI34/17, Parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110).

89. Prandaj, kërkesa e parashtruesit për shqyrtim verbal refuzohet.

Përfundim

90. Gjykata Kushtetuese vë në pah detyrimin e saj kushtetues që të sigurojë që procedurat që zhvillohen para autoriteteve publike duhet të respektojnë të drejtat themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

91. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se mospërmbarimi i Vendimit të KPMSHCK-së nga Komisioni i Ankesave të MPMS-së , sidomos pas vendimeve të gjykatave të rregullta që vërtetuan ligjshmërinë e Vendimit të KPMSHCK-së, ka rezultuar me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.

92. Gjykata rithekson se në pajtim me karakterin subsidiar të kësaj kërkese individuale nuk ka vlerësuar aspektin material të kërkesës së parashtruesit të kërkesës që ka të bëj me shpërblim jubilar dhe pagesën e tri (3) pagave sepse kjo çështje duhet të zgjidhet nga Komisioni i Ankesave i MPMS-së, siç edhe është përcaktuar me Vendimin e KPMSHCK-së [A/02/68/2016], të 12 prillit 2016. Mirëpo, Gjykata ka vlerësuar aspektin procedural të kërkesës së parashtruesit të kërkesës që ka të bëj me mospërmbarimin e Vendimit e KPMSHCK-së [A/02/68/2016], të 12 prillit 2016, ligjshmëria e të cilit është vërtetuar nga gjykatat e rregullta.

93. Gjykata vlerëson se çështja e mospërmbarimit të Vendimit të KPMSHCK-së [A/02/68/2016], të 12 prillit 2016 është çështje e garancive procedurale të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, për çka Gjykata ka konstatuar se ka rezultuar me shkelje të të drejtave themelore të njeriut.

94. Rrjedhimisht, pavarësisht pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata ka vendosur që çështjen ta kthejë për zgjidhje efektive në Komisionin kompetent të MPMS-së, në pajtim me Vendimin e KPMSHCK-së [A/02/68/2016] të 12 prillit 2016, siç është vërtetuar me vendimet e gjykatave të rregullta.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 59 (1) dhe 66 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 prill 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. TA KTHEJË çështjen për zgjidhje efektive në Komisionin kompetent të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në pajtim me Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës [A/02/68/2016] të 12 prillit 2016 siç është vërtetuar me vendimet e gjykatave të rregullta;

IV. TË KËRKOJË nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që të njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës jo më larg se 11 tetor 2021;

V. TË REFUZOJË kërkesën për mbajtje të seancës dëgjimore;

VI. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me atë kërkesë ;

VII. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'i kumtohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;

VIII. TË SHPALLË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta-Rama-Hajrizi

KI188/20, Parashtrues i kërkesës: Kompania e Sigurimeve "SUVA Rechstabteillung", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.63/2019, të 15 tetorit 2020.

KI188/20, Aktgjykim i miratuar më 28 prill 2021, publikuar më 15 qershor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, konsistenca e praktikës gjyqësore, siguria juridike, e drejta për vendim të arsyetuar*

Rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me një aksident të vitit 2013, në të cilin, i siguruari i parashtruesit të kërkesës, përkatësisht V.A., kishte pësuar lëndime fizike. Përgjegjësia për aksidentin kishte rënë mbi R.K.-në, i siguruar i BKS-së. Parashtruesi i kërkesës e kishte kompensuar të siguruarin e tij, përkatësisht V.A.-në në shumën prej 138,734 CHF, në emër të trajtimit mjekësor dhe kompensimit për shkak të paaftësisë në punë. Përkitazi me këtë shumë në vitin 2014, parashtruesi i kërkesës iu drejtua BKS-së me kërkesën për kompensim mbi bazën e të drejtës në subrogim të përcaktuar përmes LMD-së dhe në mungesë të një marrëveshjeje, iu drejtua Gjykatës Themelore përmes padisë. Gjykata Themelore, i kishte dhënë të drejtë parashtruesit të kërkesës, duke konfirmuar detyrimin e BKS-së që të kompensojë parashtruesin e kërkesës në vlerë prej 114,477.59 euro dhe gjithashtu detyrimin për të paguar kamatën prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, siç është përcaktuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, duke filluar nga 25 marsi 2014 deri në pagesën definitive. Gjykata e Apelit gjithashtu përfundimisht kishte konfirmuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës në kompensimin përkatës mbi bazën e subrogimit, por kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, përkitazi me kamatëvonesën. Gjykata e Apelit, kishte përcaktuar që kamata vjetore duhet të jetë tetë përqind (8%) në vit bazuar në nenin 382 të LMD-së dhe jo dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, siç kishte përcaktuar gjykata më e ulët. Këtë konstatim të Gjykatës së Apelit, përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës, parashtruesi i kërkesës e konteston para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KENDJ-së, për shkak të (i) cenimit të parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës së Apelit; dhe (ii) mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor

Gjykata vlerësoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me sigurinë juridike dhe të drejtën për vendim të arsyetuar, si një ndër garancitë e përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, duke mbështetur këtë vlerësim në praktikën gjyqësore të

Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ).Gjykata shtjelloi parimet e përgjithshme që burojnë nga GJEDNJ-ja dhe praktika e saj gjyqësore përkitazi me konsistencën gjyqësore dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar.

Lidhur me pretendimin për cenim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata konstatoi: (i) se në rastin nën shqyrtim nuk është provuar ekzistenca dallimeve "të thella dhe afatgjate" lidhur me qëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme; (ii) se ekziston mekanizmi për administrimin e drejtë të drejtësisë dhe për shqyrtimin e ndryshimit të praktikës gjyqësore; (iii) Gjykata Supreme më 1 dhjetor 2020 ka nxjerrë "Mendim Juridik për Kamatën lidhur me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes" bazuar në nenin 14. 2.10 të Ligjit për Gjykatat; (iv) se mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor të bazuar mbi rrjetin e gjykatave themelore dhe të apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial; (v) se cili ligj duhet zbatuar në rrethanat e rastit konkret është prerogativë dhe detyrë e Gjykatës Supreme; dhe, se (v) roli i Gjykatës Supreme është që pikërisht t'i zgjidhë konfliktet e tilla.

Lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Apelit (i) ka dhënë bazën juridike dhe ka shpjeguar se përse në rastin e parashtruesit të kërkesës zbatohet norma që përcakton kamatëvonesën prej 8%; (ii) aktgjykimi i kontestuar i Gjykatë se Apelit përmban lidhje logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe konkluzave të nxjerra; (iii) si rrjedhojë logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe konkluzave ka rezultuar se aktgjykimi i kontestuar i plotëson kushtin e një vendimi të arsyetuar; dhe, (iv) nëse parashtruesit të kërkesës i njihet e drejta për 12 % ose 8 % të kamatëvonesës është çështje e zbatimit dhe interpretimit të ligjit dhe e diskrecionit në gjykim të Gjykatës Supreme, dhe si të tilla, në vetvete, nuk bien ndesh me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Në fund, Gjykata konstatoi se, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI188/20

Parashtrues

"Suva Rechtsabteillung"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.63/2019, të 15 tetorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS
e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga kompania e sigurimeve "*Suva Rechtsabteillung*", me seli në Lucern të Zvicrës, e përfaqësuar nga ICS Assistance LL.C., përmes Besnik Z. Nikqit, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Ae.nr.63/2019] të 15 tetorit 2020 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktgjykimin [IV.EK.nr.535/2015] e 3 janarit 2019 të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 (Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 22 tetor dhe 24 nëntor 2020, respektivisht, Gjykata i kishte dërguar një shkresë Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), përkitazi me një numër rastesh të dorëzuara në Gjykatë e të cilat kontestojnë Aktgjykime të Gjykatës Supreme për sa i përket caktimit të kamatëvonesës në rastet e kërkesave për kompensim të dëmit në bazë të së drejtës për subrogim si rezultat i aksidenteve të trafikut të shkaktuara në Republikën e Kosovës. Duke sqaruar se rastet respektive para Gjykatës, ndër të tjera, kontestojnë, cenimin e sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme në raste të ngjashme, Gjykata kërkoi sqarim nëse (i) Gjykata Supreme ka nxjerrë një qëndrimi parimor në lidhje me kompensimin e dëmit dhe caktimit të kamatëvonesës përkitazi me kërkesat në kuadër të së drejtës në subrogim; dhe nëse ky nuk është rasti (ii) të njoftohet Gjykata përkitazi me praktikën e Gjykatës Supreme, se në cilat raste zbatohet neni 382 (Kamatëvonesa) i Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet Detyrimore (në tekstin e mëtejmë: LMD) dhe në cilat raste zbatohet paragrafi 6 i nenit 26 (Procedura e kërkesave për dëmshpërblim) të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm).

6. Më 1 dhjetor 2020, Gjykata Supreme (i) para Gjykatës sqaroi çështjet e ngritura përmes shkresës së lartcekur; dhe (ii) dorëzoi në Gjykatë Mendimin Juridik për Kamatën të 1 dhjetorit 2020 të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme).

7. Më 23 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

8. Më 30 dhjetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.

9. Më 13 janar 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në po të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj.

10. Më 23 shkurt 2021, Gjykata (i) njoftoi Byronë Kosovare të Sigurimit (në tekstin e mëtejmë: BKS) për regjistrimin e kërkesës dhe i mundësojë të njëjtës dorëzimin e komenteve, nëse ka, në Gjykatë.

11. Më 4 mars 2021, BKS dorëzoi komentet përkatëse në Gjykatë.

12. Më 28 prill 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese Gresa Caka-Nimani dhe, njëzëri, i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe vlerësimin e çështjes në merita.

13. Të njëjtën ditë, Gjykata votoi, njëzëri, që kërkesa është e pranueshme; por me shumicë votash, konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

14. Në të njëjtën datë, Gjyqtarja raportuese në bazë të paragrafit (4) të rregullit 58 (Këshillimet dhe Votimi) të Rregullores se punës, duke marrë parasysh që nuk ishte në mesin e shumicës së gjyqtarëve që konstatuan si më sipër, kërkoi nga Kryetarja e Gjykatës që të caktohet një gjyqtar tjetër, nga shumica, për të përgatitur Aktgjykimin pa shkelje kushtetuese.

15. Në të njëjtën datë, në bazë të rregullit të lartcekur, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, si njërin nga gjyqtaret e Kolegjit shqyrtues, për të përgatitur Aktgjykimin pa shkelje kushtetuese.

16. Më 2 qershor 2021, gjyqtari Safet Hoxha prezantoi Aktgjykimin para Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 19 dhjetor 2013, V.A., i siguruar nga parashtruesi i kërkesës, kishte pësuar lëndime në një aksidenti komunikacioni të shkaktuar nga R.K., i cili ishte i siguruar nga BKS. I siguruari i parashtruesit të kërkesës, përkatësisht, V.A., ishte kompensuar në shumën prej 138,734 CHF, në emër të "*trajtimit mjekësor dhe kompesnimit për shkak të paaftësisë në punë*".

18. Më 25 mars 2014, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për riimbursim pranë BKS-së.

19. Më 2 dhjetor 2015, duke marrë parasysh që çështja e subgrogimit nuk ishte zgjidhur përmes kërkesës së lartcekur, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi kundër BKS-së në Gjykatën Themelore, duke kërkuar kompensim dëmi në shumën prej 127,614.55 euro. BKS kishte paraqitur përgjigje në padi, përmes të cilës, kishte propozuar se kërkesëpadia duhet të refuzohet si e pabazuar.

20. Më 3 janar 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [IV. EK.nr.535/2015], (i) e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) e detyroi BKS-në, bazuar në ekspertizën përkatëse të 22 qershorit 2018, t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës shumën e kompensimit prej 114,477.59 euro; (iii) e detyroi BKS-në t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës kamatën prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, duke filluar nga 25 marsi 2014 deri në pagesën definitive; dhe (iv) e detyroi BKS-në të paguante shpenzimet e procedurës. Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit të saj, arsyetoi përcaktimin e kamatës ndëshkuese prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, duke u bazuar në paragrafin 6 të nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm.

21. Më 25 janar 2019, BKS parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ose të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Ndërsa, më 7 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi përgjigje në ankesë dhe propozoi që ankesa e BKS-së të refuzohet si e pabazuar. Ankesa dhe përgjigjja në ankesë, ndër të tjera, argumentojnë dhe kundërargumentojnë, çështje që ndërlidhen me lartësinë e kamatëvonesës, përkatësisht nëse të aplikueshme janë dispozitat e LMD-së apo të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, kishte theksuar se bazuar në nenin 382 të LMD-së, lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, ndërsa, për çështjet që ndërlidhen me sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, ligj i veçantë është Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm, dhe bazuar në nenin 26 e të cilit, lartësia e kamatëvonesës është dymbëdhjetë përqind (12%) në vit.

22. Më 15 tetor 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ae.nr.63/2019], vërtetoi pjesërisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Të njëjtin, e ndryshoi vetëm përkitazi me kamatëvonesën, duke e detyruar BKS-në që të paguajë kamatën tetë përqind (8%) nga 25 marsi 2014 e deri në pagesën definitive. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, arsyetoi se (i) paragrafi 7 i nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, "*përjashton zbatimin e kamatës prej 12% për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënjën në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim*"; dhe për pasojë, (ii) paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, ka drejtë vetëm në kamatëvonesën prej tetë përqind (8%) në vit, të përcaktuar përmes nenit 382 të LMD-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [Ae.nr.63/2019] i 15 tetorit 2020 i Gjykatës se Apelit është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës, specifikisht pretendon (i) shkelje të parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës së Apelit; dhe (ii) shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor.

24. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës, duke u referuar në Aktvendimin [E.Rev.nr. 68/2019] e 27 janarit 2020 të Gjykatës Supreme, i cili, ndër të tjera, kishte përcaktuar se revizioni nuk është i lejuar në rastet kur objekt shqyrtimi janë vetëm "*kërkesat aksesore*", përkatësisht

kamatëvonesa, pretendon se nuk ka mjete tjera juridike në dispozicion për të kontestuar Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit.

25. Përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me cenimin e sigurisë juridike, përkatësisht divergjencën në praktikën gjyqësore lidhur me përcaktimin e kamatëvonesave në raste të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, thekson se (i) Gjykata e Apelit në mënyrë të vazhdueshme ka aplikuar kamatën vjetore prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit në raste që ndërlidhen me sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, siç është përcaktuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, me përjashtim të Aktgjykimit të kontestuar; dhe (ii) për më tepër që, Aktgjykimi i kontestuar është në kundërshtim edhe me parimet e shtjelluara në Aktgjykimet e Gjykatës KI87/18, me parashtrues "*IF Skadeforsikring*", Aktgjykim i 15 prillit 2019 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI87/18) dhe KI35/18, me parashtrues "*Bayerische Versicherungsverbrand*", Aktgjykim i 6 janarit 2020 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI35/18), por edhe me vet Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme, dhe i cili "*bën përpjekje për unifikimin e praktikës gjyqësore*". Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës i referohet katër Aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit, si në vijim: (i) Aktgjykimit [Ae.nr.215/2019] të 22 shtatorit 2020; (ii) Aktgjykimit [Ae. nr. 204/2019] të 5 gushtit 2020; (iii) Aktgjykimit [Ae.nr.282/2019] të 4 gushtit 2017; dhe (iv) Aktgjykimit [Ae.nr.127/2019] të 3 marsit 2020.

26. Përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës thekson se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, (i) nuk ka adresuar pretendimin kryesor të tij të ngritur përmes përgjigjes në ankesë, përmes të cilit është argumentuar se duhet aplikuar kamata prej dymbëdhjetë përqind (12%), siç është përcaktuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, si "*lex specialis*" dhe jo kamata prej tetë përqind (8%), siç është përcaktuar në nenin 382 të LMD-së, si "*lex generalis*"; (ii) nuk është arsyetuar aplikimi i paragrafit 2 të nenit 382 të LMD-së në vend të paragrafit 6 të nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm; (iii) referenca në paragrafin 7 të nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nuk është arsyetuar, për më tepër që e njëjta, nuk "*trajton fare çështjen e kamatëvonesës dhe ndonjë përkufizimi apo përjashtimi për legjitimitetin në të drejtën e kamatëvonesës*"; (iv) në kundërshtim me Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese KI87/18 dhe KI35/18, respektivisht, nuk është arsyetuar shmangia nga praktika e saj gjyqësore në cenim të parimit të sigurisë juridike; dhe (v) neni 12 (Kërkesat e regresit të fondeve të sigurimit shëndetësor, pensional dhe invalidor) i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm e përcakton të drejtën

për shpërblim dëmi në sigurimin nga autopërgjegjësia, ndërsa përjashtimet janë qartë të përcaktuara në nenin 11 (Përjashtimet nga mbulesa siguruese) të të njëjtit ligj, e të cilat nuk janë të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret.

27. Përgjatë pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës ka shtjelluar parimet themelore të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor siç është e garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe në mbështetje të këtyre argumenteve, parashtruesi i kërkesës i është referuar edhe praktikës gjyqësore të (i) Gjykatës në rastet KI55/09, parashtrues *NTSH Meteorit*, Aktgjykim i 3 dhjetorit 2010; KI135/14, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 10 nëntorit 2015; KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017; KI87/18, cituar më lart; dhe KI35/18, cituar më lart; si dhe (ii) Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë* (Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992); *Van de Hurk kundër Holandës* (Aktgjykim i 9 prillit 1994); *Hiro Balani kundër Spanjës* (Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994); *Ruiz Torija kundër Spanjës* (Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994); *Helle kundër Holan*dës (Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997); *Souminen kundër Finlandës* (Aktgjykim i 1 korrikut 2003); *Tatishvilli kundër Rusisë* (Aktgjykim i 22 shkurtit 2007); *Boldea Kundër Romanisë* (Aktgjykim i 15 majit 2007); dhe *Grădinar kundër Moldovës* (Aktgjykim i 6 shkurt 2008).

28. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) kërkesën e tij të shpallë të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë që Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [Ae.nr. 63/2019] i 15 tetorit 2020 i Gjykatës së Apelit, është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke e shpallur të njëjtin të pavlefshëm dhe duke e kthyer çështjen në rivendosje.

Komentet e dorëzuara nga pala e interesuar BKS

29. Më 4 mars 2021, BKS dërgoi në Gjykatë komentet e saj lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Sipas BKS-së, (i) parashtruesi i kërkesës nuk ka shterruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, sepse "*nuk ka iniciuar fare revizion si mjet i jashtëzakonshëm pranë Gjykatës Supreme*"; (ii) kamatëvonesa prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, nuk mund të zbatohet në rrethanat e rastit konkret, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka parashtruar plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga BKS, siç përcaktohet në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm dhe rregulloret përkatëse të Bankës Qendrore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: BQK); (iii)

pretendimet e parashtruesit të kërkesës ngërthejnë çështje që ndërlidhen me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ndërsa sipas rastit të Gjykatës KI72/16, Gjykata "*nuk është gjykatë e shkallës së katërt*"; dhe (iv) se çdo qasje në të kundërtën "*do të cënonte rëndë parimet themeltare të rendit kushtetues dhe juridik, respektivisht Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat; Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Ligjit 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, dhe Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës*".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

32. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."*

33. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

34. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI118/18, me parashtrues *Eco Construction sh.p.k.,* Aktvendim për papranueshmëri i 10 tetorit 2020, paragrafi 29).

35. Ndërsa, për sa i përket përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj e të shtjelluara më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Ae.nr.63/2019] e 15 tetorit 2020 të Gjykatës së Apelit pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, vendimet e Gjykatës së Apelit, mund të kontestohen para Gjykatës, dhe kjo e fundit, në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar se mjetet juridike janë shterur nga parashtruesit e kërkesave të cilët kanë kontestuar vendime të Gjykatës së Apelit. Këtë praktikë gjyqësore, Gjykata e ka ndërtuar bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas së cilës, ndër të tjera, parashtruesit e kërkesave përkatëse, jodetyrimisht kushtëzohen të përdorin edhe mjetet e jashtëzakonshme juridike (shih Udhëzuesin për Kriteret e Pranueshmërisë, të 30 prillit 2020, I. Kriteret procedurale për papranueshmëri; A. Mos-shterimi i mjeteve juridike;

2. Aplikimi i rregullit; e) Ekzistenca dhe përshtatshmëria, paragrafi 89 dhe referencat e përdorura aty).

36. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

37. Gjykata gjithashtu vëren se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Meritat

38. Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me një aksident të vitit 2013, në të cilin, i siguruari i parashtruesit të kërkesës, përkatësisht V.A., kishte pësuar lëndime fizike. Përgjegjësia për aksidentin kishte rënë mbi R.K.-në, i siguruar i BKS-së. Parashtruesi i kërkesës e kishte kompensuar të siguruarin e tij, përkatësisht V.A.-në në shumën prej 138,734 CHF, në emër të trajtimit mjekësor dhe kompensimit për shkak të paaftësisë në punë. Përkitazi me këtë shumë në vitin 2014, parashtruesi i kërkesës iu drejtua BKS-së me kërkesën për kompensim mbi bazën e të drejtës në subrogim të përcaktuar përmes LMD-së dhe në mungesë të një marrëveshjeje, iu drejtua Gjykatës Themelore përmes padisë. Gjykata Themelore, i kishte dhënë të drejtë parashtruesit të kërkesës, duke konfirmuar detyrimin e BKS-së që të kompensojë parashtruesin e kërkesës në vlerë prej 114,477.59 euro dhe gjithashtu detyrimin për të paguar kamatën prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, siç është përcaktuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, duke filluar nga 25 marsi 2014 deri në pagesën definitive. Gjykata e Apelit gjithashtu përfundimisht kishte konfirmuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës në kompensimin përkatës mbi bazën e subrogimit, por kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, përkitazi me kamatëvonesën. Gjykata e Apelit, kishte përcaktuar që kamata vjetore duhet të jetë tetë përqind (8%) në vit bazuar në nenin 382 të LMD-së dhe jo dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, siç kishte përcaktuar gjykata më e ulët. Këtë konstatim të Gjykatës së Apelit, përkitazi me lartësinë e

kamatëvonesës, parashtruesi i kërkesës e konteston para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KENDJ-së, për shkak të (i) cenimit të parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës së Apelit; dhe (ii) mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor. Gjykata në vijim, do të shqyrtojë këto dy pretendime të parashtruesit të kërkesës, duke filluar me ato që ndërlidhen me cenimin e sigurisë juridike.

Përkitazi me cenimin e sigurisë juridike

(i) Parimet e përgjithshme siç janë zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës

39. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon mungesë të konsistencës, përkatësisht divergjencë në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit në lidhje me përcaktimin e kamatëvonesave në raste të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, duke u referuar në katër Aktgjykime të Gjykatës së Apelit, si në vijim: (i) Aktgjykimit [Ae.nr.215/2019] të 22 shtatorit 2020; (ii) Aktgjykimit [Ae. nr. 204/2019] të 5 gushtit 2020; (iii) Aktgjykimit [Ae.nr.282/2019] të 4 gushtit 2020; dhe (iv) Aktgjykimit [Ae.nr.127/2019] të 3 marsit 2020.

40. Gjykata vëren se të katër Aktgjykimet e Gjykatës së Apelit të referuara nga parashtruesi i kërkesës në kuptim të pretendimeve për divergjencë në praktikën përkatëse gjyqësore, (i) ndërlidhen me raste të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia; (ii) vërtetojnë Aktgjykimet përkatëse të Gjykatës Themelore përkitazi me aplikimin e kamatës prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, siç është përcaktuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm; dhe (iii) theksojnë se pretendimet e palëve përkatëse për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë nuk qëndrojnë sepse e njëjta saktë ka aplikuar ligjin e aplikueshëm, duke zbatuar nenin 26 të Ligjit për Sigurimit të Detyrueshëm në rrethanat e rasteve përkatëse. Prandaj, nuk është kontestuese se Gjykata e Apelit nuk ka vepruar njëjtë në rrethanat e rastit konkret, përkatësisht Aktgjykimit të kontestuar të saj.

41. Por, Gjykata vë theks në faktin që më 1 dhjetor 2020, Gjykata Supreme ka nxjerrë Mendimin Juridik për Kamatat, por Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, është nxjerrë para së të jetë miratuar Mendimi i lartcekur Juridik.

42. Më saktësisht, Gjykata rikujton se konstatimin lidhur me divergjencën në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme përkitazi me aplikimin e lartësisë së kamatëvonesave në rastet e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, e kishte arritur në rastet e Gjykatës, KI87/18 dhe KI35/18.

43. Përmes këtyre Aktgjykimeve, Gjykata kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e dy Aktgjykimeve të ndryshme të Gjykatës Supreme, dhe të cilat kishin ndryshuar Aktgjykimet përkatëse të Gjykatës së Apelit, përkitazi me aplikimin e kamatëvonesës në rastet e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia. Në të dy rastet, Gjykata, (i) pasi kishte shtjelluar parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së që ndërlidhen me vlerësimin e divergjencës në praktikën gjyqësore dhe kishte aplikuar të njëjtat në rrethanat e rasteve përkatëse; dhe (ii) pasi kishte analizuar në rastin KI87/17, shtatë (7) vendime të ndryshme, ndërsa në rastin KI35/18, nëntë (9) sosh, kishte konstatuar se në praktikën gjyqësore përkatëse ka *"dallime të thella dhe afatgjata"* përkitazi me aplikimin e dispozitave ligjore që ndërlidhen me lartësinë e kamatëvonesës së aplikueshme në rastet e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, për më tepër që, përkundër faktit që mekanizmat për sigurimin e konsistencës në praktikë gjyqësore janë të përcaktuar në ligjet respektive, ky mekanzimën nuk ishte përdorur nga Gjykata Supreme (shih rastin e Gjykatës, KI87/18, cituar më lart, paragrafi 79; dhe rastin e Gjykatës KI35/18, cituar më lart, paragrafi 103).

44. Përkitazi me parimin e sigurisë juridike si rezultat i mungesës së konsistencës në praktikën gjyqësore, GJEDNJ në praktikën e saj ka zhvilluar parime themelore dhe vendosur kriteret nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Kriteret e vendosura nga GJEDNJ, Gjykata gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse i ka zbatuar edhe në praktikën e saj gjyqësore (shih, ndër të tjera, rastet e lartcekura të Gjykatës KI35/18 dhe KI87/18, ku Gjykata konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së).

45. Në vijim të kësaj, Gjykata vë në pah se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka rezultuar në katër parime themelore që e karakterizojnë analizën lidhur me konsistencën e praktikës gjyqësore, si vijon: (i) se një nga komponentët thelbësorë të sundimit të ligjit është siguria juridike, e cila, ndër të tjera, garanton një siguri të caktuar në situata juridike dhe kontribuon në besim publik në gjykata (shih, mutatis mutandis,

Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë, kërkesa nr. 38155/02, Aktgjykim i 2 nëntorit 2010, paragrafi 38, Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 56, shih rastin KI35/18, të cituar më lart, paragrafi 64); (ii) se nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore (shih rastin e GJEDNJ-së, të cituar më lart, Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë, paragrafi 56, shih po ashtu rastin e cituar më lartë të Gjykatës KI35/18, parashtrues Bayerische Versicherungsverbrand, paragrafi 65, si dhe rastin KI42/17, parashtrues Kushtrim Ibraj, Aktvendim për papranueshmëri i 25 janarit 2018, paragrafi 33); (iii) se mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor i bazuar mbi rrjetin e gjykatave themelore dhe të apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial, dhe një shmangie mund të ndodhë edhe brenda të njëjtës gjykatë, e cila shmangie, në vetvete nuk mund të konsiderohet e kundërt në vetvete (shih rastin Santos Pinto kundër Portugalisë, kërkesa nr. 390005/04, paragrafi 41, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41, shih po ashtu rastin e Gjykatës KI87/17, parashtrues "IF Skadeforsikring", të cituar më lartë, paragrafi 66 dhe rastin KI35/18, parashtrues Bayerische Versicherungsverbrand, paragrafi 67); dhe (iv) përveç rasteve të arbitraritetit të dukshëm, nuk është detyrë e saj të vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendas nga ana e gjykatave vendore dhe në parim, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme (shih, për shembull, rastet e GJEDNJ-së Ādamsons kundër Letonisë, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118; dhe Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 50; dhe rastin KI35/18, të cituar më lart, paragrafi 68).

46. Megjithatë, GJEDNJ duke iu referuar parimeve të lartcekura ka vendosur tre kritere themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, si në vijim: (i) nëse ekzistojnë dallime të thella dhe afatgjata" në praktikën gjyqësore; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, Beian kundër Rumanisë (nr.1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë, Aktgjykimi i 29 nentorit 2016, paragrafët 116 - 135; Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 53; dhe shih rastin e Gjykatës, Kl29/17, parashtrues Adem Zhegrova, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shtatorit 2017, paragrafi 51 dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës të cituar më lartë, KI42/17, parashtrues Kushtrim

Ibraj, paragrafi 39, KI87/17 parashtrues IF Skadiforsikring, paragrafi 67, KI35/18 parashtrues Bayerische Versicherungsverbrand, paragrafi 70).

(ii) Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

47. Në vijim, Gjykata do të aplikoj parimet e shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret, duke aplikuar kriteret mbi bazën e të cilave GJEDNJ trajton çështjet e divergjencës përkitazi me praktikën gjyqësore, duke filluar me vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, (i) kundërthëniet e pretenduara në praktikën gjyqësore janë *"të thella dhe afatgjata";* dhe nëse ky është rasti, (ii) ekzistimin e mekanizmave të aftë për të zgjidhur divergjencën përkatëse; dhe (iii) vlerësimin nëse këta mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti në rrethanat e rastit konkret.

48. Në këtë kontekst, Gjykata duhet gjithashtu të rithekson se, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër që në raste të tilla, përkatësisht pretendimeve për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikë gjyqësore, parashtruesit e kërkesave duhet të i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar kështu në divergjencë në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin KI35/18, parashtrues "Bayerische Rechtsverbrand", të cituar më lart, paragrafi 76).

49. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon së në rastin e tij, Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshe përkitazi më lartësinë e kamatëvonesës, duke vepruar në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore. Në mbështetje të argumenteve të tij, parashtruesi i kërkesës i referohet katër Aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit, si në vijim: (i) Aktgjykimit [Ae.nr.215/2019] të 22 shtatorit 2020; (ii) Aktgjykimit [Ae. nr. 204/2019] të 5 gushtit 2020; (iii) Aktgjykimit [Ae.nr.282/2019] të 4 gushtit 2020; dhe (iv) Aktgjykimit [Ae.nr.127/2019] të 3 marsit 2020.

50. Para analizës nëse (i) Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës se Apelit, përkatësisht Aktgjykimi [E. Rev. nr.63/2019] i 15 tetorit 2020 është nxjerrë nga Gjykata e Apelit në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore; dhe (ii) divergjencat e pretenduara në praktikën gjyqësore janë "të thella dhe afatgjata", Gjykata fillimisht rikujton arsyetimin e Aktgjykimit të kontestuar përkitazi me kamatëvonesën. Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ae.nr.63/2019], vërtetoi pjesërisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe njëjtin, e ndryshoi vetëm përkitazi me kamatëvonesën, duke e detyruar BKS-në që të paguajë kamatën tetë përqind (8%) nga 25 marsi 2014 e deri në pagesën definitive. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, arsyetoi se (i) paragrafi 7 i nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, "*përjashton zbatimin e kamatës prej 12% për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënjën në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim";* dhe për pasojë, (ii) paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, ka drejtë vetëm në kamatëvonesën prej tetë përqind (8%) në vit, të përcaktuar përmes nenit 382 të LMD-së.

51. Në këtë kontekst, dhe përkitazi me ligjet e aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 maj 2012, është Dekretuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës më 30 maj 2012, është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 19 qershor 2012, dhe bazuar në nenin 1059 të tij (Hyrja në fuqi), ka hyrë në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, rrjedhimisht më 19 dhjetor 2012, ndërsa Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 23 qershor 2011, është Dekretuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës më 5 korrik 2011, është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 14 korrik 2011, dhe bazuar në nenin 44 të tij (Hyrja në fuqi), ka hyrë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare, rrjedhimisht më 29 korrik 2011. Për më tepër, ky ligj, përmes nenit 43 të tij, ka përcaktuar shfuqizimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/25 që rregullon sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë si dhe aktet respektive nënligjore të Bankës Qendrore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: BQK), e të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj.

52. Në kontekst të Aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit të referuara nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se të katër këto Aktgjykime të lartcekura të Gjykatës së Apelit të referuara nga parashtruesi i kërkesës në kuptim të pretendimeve për divergjencë në praktikën përkatëse gjyqësore, (i) ndërlidhen me raste të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia; (ii) vërtetojnë Aktgjykimet përkatëse të Gjykatës Themelore përkitazi me aplikimin e kamatës

prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, siç është përcaktuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm; dhe (iii) theksojnë se pretendimet e palëve përkatëse për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë nuk qëndrojnë sepse e njëjta saktë ka aplikuar ligjin e aplikueshëm, duke zbatuar nenin 26 të Ligjit për Sigurimit të Detyrueshëm në rrethanat e rasteve përkatëse.

53. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore, i kishte dhënë të drejtë parashtruesit të kërkesës, duke konfirmuar detyrimin e BKS-së që të kompensojë parashtruesin e kërkesës në vlerë prej 114,477.59 euro dhe gjithashtu detyrimin për të paguar kamatën prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, siç është përcaktuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, duke filluar nga 25 marsi 2014 deri në pagesën definitive. Gjykata e Apelit gjithashtu përfundimisht kishte konfirmuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës në kompensimin përkatës mbi bazën e subrogimit, por kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, përkitazi me kamatëvonesën.

54. Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit në ndryshimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore përkitazi me kamatëvonesën, kishte përcaktuar që kamata vjetore duhet të jetë tetë përqind (8%) në vit bazuar në nenin 382 të LMD-së dhe jo dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, siç kishte përcaktuar gjykata më e ulët.

55. Gjykata thekson se ajo vlerëson konsistencën e praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta vetëm në raport me shkeljet e pretenduara të parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, mungesa e konsistencës në praktikë gjyqësore duhet të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës. Për të konstatuar një shkelje të tillë, dhe për të konstatuar se të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës janë shkelur si rezultat i *"dallimeve të thella dhe të afatgjata*" në praktikën përkatëse gjyqësore, rrethanat faktike dhe juridike të rastit të parashtruesit të kërkesës duhet të përkojnë më ato të rasteve kundërthënia me të cilat pretendohet.

56. Në kontekst të rrethanave të rastit, Gjykata dhe GJENDJ gjithashtu kanë pranuar se kundërthëniet në praktikën gjyqësore janë pjesë përbërëse e secilit sistem gjyqësor dhe që divergjenca në praktikë gjyqësore mund të ketë edhe brenda të së njëjtës gjykatë. Një e gjë e tillë, nuk është detyrimisht në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih rastet e GJEDNJ-së, Santo Pinto kundër Portugalisë, cituar më lart, paragrafi 41; dhe Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin

kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 51). Për më tepër, dhe siç është cekur më lart, GJEDNJ ka theksuar vazhdimisht se kërkesat për siguri juridike dhe mbrojtje legjitime të besimit të publikut në gjykata nuk garantojnë një të drejtë në praktikë gjyqësore konsistente. Zhvillimi i praktikës gjyqësore është i rëndësishëm për të mbajtur dinamikën e duhur të përmirësimit të vazhdueshëm të administrimit të drejtësisë (shih rastin e GJEDNJ-së, Atanasovski kundër "Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë", Aktgjykim i 14 janarit 2010, paragrafi 38; dhe Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 58, shih rastin e Gjykatës KI35/18, me parashtrues Bayerische Rechtsverbrand, të cituar më lart, paragrafi 98). Përjashtim nga këto parime të përgjithshme, është arbitrariteti i dukshëm, dhe në kuptim të vlerësimit të mungesës së konsistencës gjyqësore, vlerësimi nëse ka "dallime të thella dhe afatgjata" në praktikën përkatëse gjyqësore dhe nëse ka një mekanizëm efektiv për të adresuar të njëjtat.

57. Gjykata, duke ju referuar praktikës së vet gjyqësore, përkatësisht rasteve KI87/18 dhe KI35/18, rikujton se kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të shkeljes së parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës së praktikës gjyqësore, në rastin KI87/18 në vlerësimin e 3 (tre) rasteve të Gjykatës Supreme, të nxjerra në një periudhë kohore 3 (tre) vjeçare, dhe në rastin KI35/18 në vlerësimin e 9 (nëntë) rasteve të Gjykatës Supreme të nxjerra në një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare dhe pasi kishte konstatuar se (i) kishte "dallime të thella dhe afatgjata"; (ii) mekanizmi i Gjykatës Supreme për harmonizimin e praktikës gjyqësore ekzistonte; por se (iii) mekanizmi i lartpërmendur nuk ishte përdorur (shih rastet e Gjykatës KI87/18, cituar më lart, paragrafi 79 dhe paragrafët 81 deri 85, dhe rastin KI35/18, cituar më lart, paragrafi 70 dhe paragrafët 110-111).

58. Në anën tjetër, vetëm konstatimi se ka *"dallime të thella dhe afatgjata"* në praktikën gjyqësore përkitazi me lartësinë e kamatëvonesave, nuk rezulton detyrimisht në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Për të konstatuar një gjë të tillë, Gjykata duhet të shqyrtoj edhe dy kriteret tjera të GJEDNJ-së që ndërlidhen me vlerësimin e mungesës së konsistencës në praktikë gjyqësore, përkatësisht nëse ligji i aplikueshëm përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjencë të tilla; dhe nëse një mekanizëm i tillë është zbatuar në rrethanat e një rasti dhe me çfarë efekti.

59. Gjykata thekson se Gjykata Supreme ka një mekanizëm që mundëson zgjidhjen e kundërthënieve të tilla, bazuar në pikën 10 të paragrafit 2 të nenit 14 (Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryetarit dhe nënkryetarit të Gjykatës) të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Gjykatat), Kryetarët e gjykatave përmes takimeve vjetore të të gjithë gjyqtarëve kanë detyrimin, ndër të tjera, për të për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika (shih rastin e Gjykatës KI87/18 parashtrues "IF Skadeforsikring", cituar më lart, paragrafi 80 dhe rastin KI35/18, parashtrues Bayerische Rechtsverbrand, të cituar më lart, paragrafi 107).

60. Në vijim, dhe me qëllim të qartësimit nëse një mekanizëm i tillë për zgjidhjen e kundërthënieve, të cila në vazhdimësi ishin pretenduar nga parashtruesit e kërkesave në raste të tilla para Gjykatës, Gjykata rikujton se në kërkesën e saj, të 22 tetorit 2020, Gjykatës Supreme i ishte drejtuar edhe me pyetjen nëse: "*Gjykata Supreme kishte nxjerrë ndonjë qëndrim parimor në lidhje me kompensimin e dëmit dhe caktimit të kamatëvonesës përkitazi me kërkesat në kuadër të së drejtës në subrogim*".

61. Gjykata Supreme në përgjigjen e saj ndaj pyetjes së lartcekur ishte përgjigjur si në vijim:

Praktikën gjyqësore të përshkruar më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës e ka të konsoliduar prej kur janë paraqitur kërkesat për kompensim të dëmit sipas të drejtës së subrogimit, por duhet dalluar rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës në procedurën sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike nuk mundet të ndryshoje vendimet e instancave më të ulëta ne raste kur do të konsiderohej cenim i parimit "reformatio in peius".

Me dispozitën e nenit 203 te Ligjit për Procedurën Kontestimore është përcaktuar se: " Gjykata e shkalles së dytë nuk mund ta ndryshoje aktgjykimin e shkalles së parë në dëm të palës ankuese, po qe se vetëm ajo ka bërë ankim, e jo edhe pala kundërshtare".

Parimi i cituar e pengon Gjykatën Supreme të ndryshojë vendimet e instancave më të ulëta edhe sa i përket normës vjetore të kamatëvonesës nëse revizioni është i palës paditëse, e cila pjesërisht e ka fituar kontestin gjyqësor, por ka paraqit revizion për pjesën e refuzuar. Në këtë rast Gjykata Supreme edhe nëse e konstaton se gabimisht janë zbatuar dispozitat material juridike për kamatëvonesën nuk mund të ndryshoje vendimin gjyqësor. Po ashtu, Gjykata Supreme, kur revizioni është paraqitur vetëm përkitazi me

kamatën nuk mund të lëshohet fare në vlerësimin e bazueshmëriseë së tij dhe eventualisht të ndryshojë aktgjykimet e instancës më të ultë, sepse në këtë situatë revizioni fare nuk është i lejuar në pajtim me nenin 211 paragrafi 2, i LPK-se, pasi që në kuptim të nenit 30 paragrafi 1, të LPK-se, për vlerat e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore, e jo edhe kamata (neni 30 paragraf2 te LPK-së).

Gjykata Supreme e Kosovës në refleksion të kërkesave të vazhdueshme të gjykatave të instancave më të ulëta, por edhe nga të gjeturat në praktiken e saj gjyqësore para disa muajsh ne degën civile është iniciuar ideja për nevojën e një mendimi juridik për çështjen e kamatës, për te cilën ide janë bërë hulumtime në praktikën e brendshme, janë bërë analiza krahasimore për legjislacionin dhe praktiken në regjion, është vlerësuar nevoja e ruajtjes se kontinuitetit, por edhe nevoja për ndryshime progresive në funksion të përmbushjes së standardeve për mbrojte adekuate gjyqësore dhe pas mbajtjes së shumë takimeve, kjo ide është materializuar ne mendim juridik, fillimisht në degën civile të Gjykatës Supreme dhe pastaj në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të mbajtur me datë 01 dhjetor 2020.

Mendimi juridik për çështjen e kamatës ka adresuar përveç të tjerave edhe situatën e regresit të kërkesave, pika IX (nëntë) e mendimit juridik. Pjesë të kësaj përgjigje për informatat e kërkuara ju lutem ta konsideroni edhe Mendimin juridik për kamatën, një kopje të se cilit e gjeni të bashkangjitur."

62. Megjithatë, Gjykata përmes rastit të tanishëm gjithashtu thekson se pika 4 e paragrafit 1 të nenit 26 (Kompetencat e Gjykatës Supreme) të Ligjit për Gjykatat, përcakton kompetencën ekskluzive të vet Gjykatës Supreme për të përcaktuar qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Republikës së Kosovës. Në çështjen që ngërthejnë rrethanat e rastit konkret, përkatësisht aplikimin e lartësisë së kamatëvonesës përkitazi më sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, Gjykata Supreme, një mekanizëm të tillë, përkatësisht një mendim juridik përkitazi me kamatën e kishte aprovuar më 1 dhjetor 2020, gjegjësisht pasi që parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë dhe pas kërkesës së Gjykatës, përmes të cilës ishte kërkuar që të sqarohej nëse Gjykata Supreme ka nxjerrë ndonjë qëndrim unifikues përkitazi me praktikën e saj gjyqësore.

63. Rrjedhimisht, Gjykata duke iu referuara edhe katër rasteve të lartcekura të Gjykatës së Apelit të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës dhe përgjigjes së Gjykatës Supreme, përmes shkresës së saj të 2 dhjetorit 2020, konstaton se në rrethanat e rastit konkret, nuk plotësohen të tri kriteret e GJEDNJ-së përkitazi me vlerësimin nëse mungesa e konsistencës, përkatësisht divergjencat në praktikë gjyqësore, kanë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

64. Gjykata, së pari rithekson se në rrethanat e rastit konkret nuk ka konstatuar *"dallime të thella dhe afatgjata"* në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit përkitazi me aplikimin e dispozitave që rregullojnë lartësinë e kamatëvonesës në kontekst të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia më dorëzimin e vetëm kater (4) vendimeve. Së dyti, Gjykata konsideron se sqarimi i dhënë i Gjykatës Supreme përmes shkresës së saj në lidhje me zbatimin e dispozitave të ligjit në rastet e kërkesave që i referohen caktimit të lartësisë së kamatëvonesës në kuadër të së drejtës në subrogim është i qartë. Përderisa sa i përket mekanizimit të Gjykatës Supreme për harmonizimin e kësaj praktikë, respektivisht aprovimi i Mendimit ligjor përkitazi me Kamatën, Gjykata thekson se ky mekanizëm është krijuar dhe është aprovuar pas parashtrimit të një numër rasteve në Gjykatë e të cilat kontestojnë vendimet e gjykatave të rregullta për sa i përket përcaktimit të kamatëvonesës në rastet e kërkesave për kompensim të dëmit në bazë të së drejtës për subrogim.

65. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Aktgjykim i kontestuar i Gjykatës se Apelit nuk është i përfshirë në cenim të parimit të sigurisë juridike dhe në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të parashtruesit të kërkesës, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përkitazi me vendimin e arsyetuar gjyqësor

(i)Parimet e përgjithshme lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore

66. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet Hadjianastassiou kundër Greqisë, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; Van de Hurk kundër Holandës, Aktgjykim i 19 prillit 1994; Hiro Balani kundër Spanjës, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; Higgins dhe të

tjerët kundër Francës, Aktgjykimi i 19 shkurtit 199 8; Garcia Ruiz kundër Spanjës, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; Hirvisaari kundër Finlandës, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; Suominen kundër Finlandës, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; Buzescu kundër Rumanisë, Aktgjykim i 24 majit 2005; Pronina kundër Ukrainës, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe Tatishvili kundër Rusisë, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, me parashtrues Naser Husaj, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, me parashtrues "IKK Classic", Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, me parashtrues Muharrem Blaku dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI24/17, me parashtrues Bedri Salihu, Aktgjykim i 27 majit 2019; KI35/18, cituar më lart; dhe KI227/19, me parashtrues N.T. "Spahia Petrol", Aktgjykim i 31 dhjetorit 2020.

67. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në 31 të Kushtetutës përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues Albert Rakipi, të cituar më lart, paragrafi 139).

68. Gjykata, po ashtu thekson se, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, e cila mbështetet në praktikën gjyqësorë të GJEDNJ-së, gjatë vlerësimit të parimit, i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih, në mënyrë të ngjashme, rastet e GJEDNJ-së Garcia Ruiz kundër Spanjës, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; Hiro Balani kundër Spanjës, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe Higgins dhe të tjerët kundër Francës, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues IKK Classic, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 IF Skadeforsikring, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin Morerira Ferreira kundër Portugalisë, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues Albert Rakipi, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

69. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih rastet e Gjykatës KI 87/18 parashtrues "IF Skadeforsikring", Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; KI138/19, parashtrues Ibish Raci, cituar më lart, paragrafi 45; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues Albert Rakipi, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138).

(ii) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

70. Në aplikimin e parimeve të përgjithshme e të shtjelluara më lart, në rrethanat e rastit konkret, dhe në mënyrë që të vlerësohet nëse Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në përputhje me garancitë kushtetuese për një vendim të arsyetuar gjyqësore, Gjykata rikujton që në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar të saj, Gjykata e Apelit kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, përkitazi me kamatëvonesën. Kjo e fundit, në rrethanat e rastit konkret, kishte aplikuar kamatën në lartësinë prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, duke u referuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, ndërsa Gjykata e Apelit kishte përcaktuar se në rrethanat e rastit përkatës, nuk është i aplikueshëm nenin 26 i Ligjit për Sigurimin nga Autopërgjegjësia, por duhet të aplikohet kamata në lartësinë prej tetë përqind (8) %, duke u referuar në nenin 382 të LMD-së.

71. Në konteskt të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës Gjykata, në vijim, rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit në Aktgjykimin [Ae.nr.63/2019], ku përkitazi me kamatëvonesën, theksohet si në vijim:

> *"Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale qëndron në faktet se, kamata e aprovuar nga gjykata e shkalles së parë, ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për regresim të borxhit por vetëm në kërkesat e trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblim të dëmit në procedurën jashtëgjyqësore ashtu siç parashihet në nenin 26 të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, në të cilat dispozita thirret gjykata e shkallës së parë. Kamata e aplikuar nga gjykata e shkalles së parë është parapare me qëllime të disiplinimit të kompanive siguruese në raportet e sigurimit ndaj kërkesave për dëmshpërblim të*

personave të dëmtuar të cilat kërkesa kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që t'i trajtojnë me urgjencë brenda afateve të parapara sipas dispozitave të lartpërmendura.

Paragrafi 7, i nenit 26 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, përjashton zbatimin e kamatës prej 12% për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënien në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim. Nga kjo rezulton se paditësi ka të drejtë vetëm në kamatëvonesë të paraparë me nenin 382 të LMD-së, por jo edhe kamatë të kualifikuar sipas dispozitave të zbatuara nga gjykata e shkallës së parë. Meqenëse, paditësja me kërkesën e datës 23.03.2014 ka kërkuar regresim të borxhit nga e paditura, rezulton se e paditura nga kjo datë ka rënë në vonesë kur nuk ka mbushur detyrimin brenda afatit deri në pagesën definitive."

72. Bazuar në arsyetimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit, Gjykata vëren se e njëjta, fillimisht (i) konstaton se kamata prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, është *"paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënien në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim";* (ii) përjashton aplikimin e kësaj kamate, në rrethanat e rastit konkret, duke u bazuar në paragrafin 7 të nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm; dhe (iii) konstaton se në rrethanat e rastit përkatës, aplikohet një ligj tjetër, përkatësisht neni 382 i LMD-së, i cili parasheh kamatëvonesën prej tetë përqind (8%) në vit.

73. Bazuar në arsyetimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit, Gjykata vë theks në faktin se e njëjta e ka përjashtuar aplikimin e kamatëvonesës prej dymbëdhjetë përqind (12%), siç është përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm duke aplikuar për pasojë nenin 382 të LMD-së.

74. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet nenit 382, paragrafit 2 të LMD-së, i cili përcakton që: *"Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë."*

75. Ndërsa paragrafi 6 i nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm përcakton që: "*Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga*

siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim."

76. Duke u bazuar në atë si më lart, Gjykata vëren se në përcaktimin e kamatëvonesës *"në lartësi prej 8%"* sipas paragrafit 2 të nenit 382 të LMD-së Gjykata e Apelit specifikoi se përkitazi me lartësinë kamatëvonesës në rastet e kërkesave sipas së drejtës në subrogim, në të cilat raste hyn edhe rasti i parashtruesit të kërkesës, paragrafi 6 i nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nuk është i aplikueshëm.

77. Për më tepër, Gjykata vëren se si arsye për ndryshimin e vendimit në lidhje me lartësinë e kamatëvonesës, Gjykata e Apelit arsyeton se gjykata e shkallës më të ulët, respektivisht Gjykata Themelore gabimisht kanë interpretuar të drejtën materiale kur kanë konstatuar se paragrafi 6 i nenit 26 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm është i aplikueshëm.

78. Gjykata në kontekst të pretendimeve të ngjashme që ndërlidhen me lartësinë e kamatëvonesës, më 22 tetor dhe 24 nëntor 2020, respektivisht, i dërgoi një shkresë Gjykatës Supreme, përkitazi me një numër rastesh të dorëzuara në Gjykatë e të cilat kontestojnë vendimet e gjykatave të rregullta për sa i përket përcaktimit të kamatëvonesës në rastet e kërkesave për kompensim të dëmit në bazë të së drejtës për subrogim si rezultat i aksidenteve të trafikut të shkaktuara në Republikën e Kosovës. Gjykata kërkoi sqarim nëse (i) Gjykata Supreme ka nxjerrë një qëndrimi parimor në lidhje me kompensimin e dëmit dhe caktimit të kamatëvonesës përkitazi me kërkesat në kuadër të së drejtës në subrogim; dhe nëse ky nuk është rasti (ii) të njoftohet Gjykata përkitazi me praktikën e Gjykatës Supreme, se në cilat raste zbatohet neni 382 (Kamatëvonesa) i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet Detyrimore (në tekstin e mëtejmë: LMD) dhe në cilat raste zbatohet paragrafi 6 i nenit 26 (Procedura e kërkesave për dëmshpërblim) të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (në tekstin e mëtejmë: Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm).

79. Në pyetjen e lartcekur të Gjykatës, Gjykata Supreme ishte përgjigjur si në vijim:

"Në këtë kontekst, në mënyrë parimore lidhur me kamatëvonesën për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, është zbatuar dispozita ligjore nga neni 277 i Ligjit mbi

Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-se, nr.29178, 39/85, 57/89), ndërsa për marrëdhëniet e detyrimeve që janë lindur pas datës 19.12.20[12] është zbatuar dispozita nga neni 382 te Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, date 19.06.2012, kurse për kërkesat e palëve të treta ndaj Kompanive të Sigurimeve, ne rastet kur janë plotësuar kushtet ligjore pas hyrjes në fuqi (me datën 30 korrik 2011) të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 4, me datën 14 korrik 2011, janë zbatuar dispozita e këtij ligji.

Sipas Gjykatës Supreme "Rastet e kërkesave për kompensim të dëmit në bazë të së drejtës së subrogimit në praktiken e Gjykatës Supreme të Kosovës, varësisht nga koha e lidhjes se detyrimit janë shqyrtuar dhe vendosur në përputhje me dispozitat e ligjeve të cituara më sipër, me specifika përkatëse [...]"

80. Ndërsa përkitazi me përcaktimin e kamatëvonesës në lartësi prej 12%, Gjykata Supreme kishte sqaruar se: "*Kamata në lartësi prej 12% të interesit vjetor zbatohet/llogaritet kur plotësohen kushtet ligjore në rastet e mos respektimit të afateve (neni 26 paragrafi 1 dhe 2, i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011) dhe mos përmbushjes së detyrimit (neni 26 paragrafi 4, i Ligjit të njëjtë) nga ana e siguruesve përgjegjës (Kompanitë e Sigurimeve) për çdo dite vonese deri në shlyerjen e detyrimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Situata e përshkruar sipas dispozitave nga neni 26 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i referohet përgjegjësisë që kanë Kompanitë e Sigurimeve ndaj palëve të treta, prandaj norma e vjetore e interesit në lartësi prej 12 % në këtë rast ka për synim që të nxitë një lloj qasje korrekte të Kompanive të Sigurimeve ndaj palëve të treta, në mënyrë që kërkesat për kompensimin e dëmeve të trajtohen brenda afateve ligjore, pëmdryshe Kompanitë e Sigurimeve do të paguajnë edhe interesin vjetor prej 12%.*

Norma e interesit vjetor prej 12% ne raste te caktuara me ligj duhet të vlerësohet si një lloj ndëshkimi ndaj Kompanive te Sigurimeve, kur ato nuk janë të përgjegjshme ndaj palëve të treta, por nuk mund të konsiderohet si favorizim i kërkesës së kreditorit me të drejtë regresi ndaj debitorit me detyrim sepse marrëdhënia e kreditorit dhe e të detyruarit në pagesën e regresit është marrëdhënie e veçantë e detyrimeve dhe nuk është raporti i palës së tretë me Kompaninë e

Sigurimeve, prandaj për kërkesën e palës së trete si palë e dëmtuar në raport me Kompaninë e sigurimeve në raste të caktuara mund të gjykohet norma e interesit vjetor prej 12%, por jo edhe për kërkesën e rimbursimit."

81. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata konsideron se përgjigja e dhënë nga Gjykata Supreme lidhur me interpretimin e saj se cili ligj do të zbatohet përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës është në pajtueshmëri me arsyetimin e dhënë në Aktgjykimin e kontestuar nga parashtruesi i kërkesës në rastin konkret. Prandaj, Gjykata konsideron se interpretimi dhe zbatim i dispozitave përkatëse ligjore në përcaktimin e kamatëvonesës nga Gjykata e Apelit në rastin e parashtruesit të kërkesës hynë në sferën e ligjshmërisë, e që është në juridiksionin e kësaj gjykate. Thënë këtë, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj dhe sqarimit/përgjigjes të dhënë nga Gjykata Supreme ndaj pyetjes së Gjykatës ka arritur të shpjegojë raportin midis fakteve të paraqitura dhe zbatimit të ligjit në të cilin ajo është thirrur, gjegjësisht në çfarë mënyre ato vijnë në korrelacion me njëra tjetrën dhe se si kanë ndikuar ato në vendimin e Gjykatës se Apelit që t'i ndryshojë vendimet e gjykatës së shkallës më të ulët përkitazi me përcaktimin e lartësisë së kamatëvonesës.

82. Duke vepruar kështu, Gjykata rithekson se Gjykata e Apelit e ka përmbushur detyrimin e saj kushtetues për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor, sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së.

83. Prandaj, bazuar në si më sipër, konstaton se Aktgjykimi [Rev. Nr. 63/2019] i 15 tetorit 2020, të Gjykatës së Apelit përkitazi me pretendimin për mos arsyetim të vendimit gjyqësor nuk përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përfundime

84. Gjykata ka trajtuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar mbi këtë vlerësim praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së përkitazi me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit dhe parimin e sigurisë juridike në aspektin e konsistencës së praktikës gjyqësore, garanci këto, që me përjashtime të caktuara, janë të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

85. Së pari, sa i përket pretendimit që ndërlidhet me mosarsyetim të vendimit gjyqësor, Gjykata ka konstatuar se Aktgjykimi [E.Rev.nr.

63/2019] i 15 tetorit 2020, i Gjykatës së Apelit nuk është i përfshirë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së ka arsyetuar mjaftueshëm vendimin e saj.

86. Së dyti, sa i përket parimit të sigurisë juridike në kontekst të mungesës së konsistencës, përkatësisht divergjencës së praktikës gjyqësore të Gjykatës se Apelit, Gjykata pasi shtjelloi parimet dhe kriteret themelore të GJEDNJ-së në këtë aspekt, aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret, dhe konstatoi se në praktikën gjyqësore të Gjykatës se Apelit nuk ka *"dallime të thella dhe afatgjata"* përkitazi me aplikimin e dispozitave ligjore që ndërlidhen me lartësinë e kamatëvonesës së aplikueshme në rastet të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, dhe rrjedhimisht konstatoi se nuk ishte cenuar parimi i sigurisë juridike, dhe se Aktgjykimi [E.Rev.nr. 63/2019] i 15 tetorit 2020 nuk ishte nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 prill 2021,

VENDOS

I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ae.nr.63/2019, të 15 tetorit 2020, është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

IV. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari që përgatiti Vendimin **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Safet Hoxha Arta Rama-Hajrizi

KI111/19, Parashtrues i kërkesës: Kompania e Sigurimeve "SUVA Rechstabteillung", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme E. Rev. nr. 1/2019, të 27 shkurtit 2019

KI111/19, Aktgjykim i miratuar më 28 prill 2021, publikuar më 16 qershor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, konsistenca e praktikës gjyqësore, siguria juridike, e drejta për vendim të arsyetuar*

Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike lidhur me regresin për shpenzimet e trajtimit mjekësor dhe kompensimit për paaftësi të të dëmtuarit SB në aksidentin e komunikacionit të 1 majit 2013. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që të detyrohet pala e paditur Kompania e Sigurimeve "Elsig" që në emër të regresit t'ia paguaj shumën e përgjithshme të mjeteve në lartësi të caktuar të valutës në euro së bashku me normën vjetore në lartësi prej 12%. Gjykatat e instancës më të ulët miratuan shumën e regresit dhe lartësinë e kamatës prej 12% të kërkuar nga parashtruesi i kërkesës, mirëpo, pas revizionit të palës së paditur, Gjykata Supreme vendosi që lartësia e kamatës që duhet t'i akordohet parashtruesit të kërkesës është 8% dhe jo në lartësi prej 12% siç ia kishin akorduar më herët gjykatat e instancës më të ulët. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar, mes tjerash, shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), përkitazi me sigurinë juridike dhe të drejtën për vendim të arsyetuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me sigurinë juridike dhe të drejtën për vendim të arsyetuar, si një ndër garancitë e përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, duke mbështetur këtë vlerësim në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ).Gjykata shtjelloi parimet e përgjithshme që burojnë nga GJEDNJ-ja dhe praktika e saj gjyqësore përkitazi me konsistencën gjyqësore dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar.

Lidhur me pretendimin për cenim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata konstatoi: (i) se në rastin nën shqyrtim nuk është provuar ekzistenca dallimeve "të thella dhe afatgjate" lidhur me qëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme; (ii) se ekziston mekanizmi për administrimin e drejtë të drejtësisë dhe për shqyrtimin e ndryshimit të praktikës gjyqësore; (iii) Gjykata Supreme më 1 dhjetor 2020 ka nxjerrë "Mendim Juridik për

Kamatën lidhur me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes" bazuar në nenin 14. 2.10 të Ligjit për Gjykatat; (iv) se mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor të bazuar mbi rrjetin e gjykatave themelore dhe të apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial; (v) se cili ligj duhet zbatuar në rrethanat e rastit konkret është prerogativë dhe detyrë e Gjykatës Supreme; dhe, se (v) roli i Gjykatës Supreme është që pikërisht t'i zgjidhë konfliktet e tilla.

Lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata Supreme (i) ka dhënë bazën juridike dhe ka shpjeguar se përse në rastin e parashtruesit të kërkesës zbatohet norma që përcakton kamatëvonesën prej 8%; (ii) aktgjykimi i kontestuar i Gjykatë Supreme përmban lidhje logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe konkluzave të nxjerra; (iii) si rrjedhojë logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe konkluzave ka rezultuar se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme plotëson kushtin e një vendimi të arsyetuar; dhe, (iv) nëse parashtruesit të kërkesës i njihet e drejta për 12 % ose 8 % të kamatëvonesës është çështje e zbatimit dhe interpretimit të ligjit dhe e diskrecionit në gjykim të Gjykatës Supreme, dhe si të tilla, në vetvete, nuk bien ndesh me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Në fund, Gjykata konstatoi se, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KI111/19

Parashtrues

Kompania e Sigurimeve "SUVA Rechstabteillung"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme E. Rev. nr. 1/2019, të 27 shkurtit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania e sigurimeve "SUVA Rechstabteillung" nga Lucerni në Zvicër (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), e përfaqësuar nga Shoqëria e avokatisë "ICS Assistance L.L.C Prishtine" të përfaqësuar nga Visar Morina dhe Besnik Nikqi avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 1/2019], të 27 shkurtit 2019.

3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 14 mars 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 2 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 3 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.

8. Më 2 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

9. Më 2 shtator 2019, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Themelore në Prishtinë me kërkesë për dorëzim të fletëkthesës që tregon ditën e pranimit të vendimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.

10. Më 16 shtator 2019, Gjykata Themelore dorëzoi dokumentin e lartpërmendur në Gjykatë.

11. Më 22 tetor 2020, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme që të njoftohet për praktikën gjyqësore lidhur me aplikimin e kamatëvonesës në kontestet e subrogimit të borxhit. Kërkesa drejtuar Gjykatës Supreme

përveç rastit nën shqyrtim KI111/19 ndërlidhej edhe me rastet tjera por të natyrës së ngjashme KI74/19, KI09/20 dhe KI113/20.

12. Më 2 dhjetor 2020, Gjykata Supreme dorëzoi "Mendim Juridik për Kamatën i miratuar në mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës i 1 dhjetorit 2020, i bazuar në nenin 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat". Pjesët relevante të mendimit Juridik të Gjykatës Supreme janë reflektuar në tekstin e mëposhtëm të këtij aktgjykimi.

13. Më 28 prill 2021, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe vlerësim në merita.

14. Të njëjtën ditë, Gjykata votoi, njëzëri që kërkesa është e pranueshme; dhe me shumicë votash, se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përmbledhja e fakteve

15. Nga dokumentet e dorëzuara rezulton se më 1 maj 2013, i siguruari i parashtruesit të kërkesës SB drejtues i automjetit "VE Polo" me targa 05-867-BM ishte aksidentuar me automjetin e udhëtarëve me targa E-310-EH që drejtohej nga MD, i cili ishte i siguruar tek pala e paditur Kompania e Sigurimeve "Elsig" në Prishtinë.

16. Ndërkohë, në procedurë penale, Gjykata Themelore në Ferizaj me Aktgjykim penal të formës së prerë (P.nr. 1448/13, të datës 21.11.2013) kishte vërtetuar se fajtor "ekskluziv" për aksidentin e 1 majit 2013 kishte qenë MD, i siguruar i palës së paditur Kompanisë së Sigurimeve "Elsig" në Prishtinë.

17. Më 11 mars 2014, Parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë tek kompania e sigurimeve "Elsig" kërkesën për kompensim dhe që të caktohet lartësia e kamatës në 12 % bazuar në nenin 26 pika 6 të Ligjit Nr. 04/L-018 mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Autopërgjegjësinë).

18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin e mëtejmë, Gjykata Themelore) lidhur me regresin për shpenzimet e trajtimit mjekësor dhe kompensimit për paaftësi të të dëmtuarit SB në aksidentin e komunikacionit të 1 majit

2013. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që të detyrohet pala e paditur Kompania e Sigurimeve "Elsig" që në emër të regresit t'ia paguaj shumën e përgjithshme të mjeteve në lartësi prej 80.037,04 euro së bashku me normën vjetore në lartësi prej 12 %.

19. Më 26 shtator 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike (Aktgjykim III. C. nr. 150/2015) (i) aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) detyroi të paditurën kompaninë e sigurimeve "Elsig" me seli në Prishtinë, që në emër të regresit t'ia paguaj shumën e përgjithshme të mjeteve në lartësi prej 80.037,04 euro së bashku me normën vjetore në lartësi prej 12 %; dhe, (iii) detyroi të paditurën që parashtruesit të kërkesës t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës.

20. Gjykata Themelore duke u bazuar në ekspertizat mjekësore dhe të komunikacionit kishte vërtetuar: (i) se i siguruari i të paditurës MD është fajtor për dëmin e shkaktuar në aksidentin e 1 majit 2013; (ii) se i lënduari SB ka pasur shpenzime mjekësore si dhe kompensim për paaftësi për punë në shumë prej 80.037,04 euro; dhe, (iii) meqenëse shkaktar i aksidentit ka qenë i siguruari i palës së paditur, Gjykata Themelore duke u bazuar në nenet 281 dhe 960 të Ligjit nr. 04/l-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejmë: LMD) vendosi që ta detyroj palën e paditur që parashtruesit të kërkesës t'ia regresoi 80.037,04 euro së bashku me normën vjetore në lartësi prej 12 %.

21. Në pjesën relevante të aktgjykimit, Gjykata Themelore kishte përcaktuar: "*Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e te paditurës se paditësi nuk mund qe bazën ligjore te kërkesëpadisë ta mbështet ne nenin 72 te Ligjit Federal Zviceran i sigurimit social një pretendimi te tille gjykata e refuzoj si te pabazuar pasi qe paditësi bazën ligjore e ka mbështetur ne përputhje me nenin 281 dhe 960 te LMD-se ku te njëjta dispozita e trajtojnë subrogimin ne sigurime, edhe pretendime te tjera te te paditurit gjykata i refuzoj si te pa bazuara për shkak se ishin jo relevante për te vendosur ndryshe lidhur me këtë çështje civile juridike, pasi qe edhe paditësi ka zbritur shumen e paguar te dhënë sipas mendimit dhe konstatimit te ekspertizës mjekësore. Gjykata e detyroj te paditurin qe t'ia paguaj paditësit, shumat e gjykuara te kompensimit se bashku me normën e kamatës, ne lartësi prej 12%, konform nenit 26.6 te Ligjit 04/L-018 mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë e cila u llogarit nga data e paraqitjes se kërkesës për rimbursim tek e paditura 11.03.2014 e deri ne pagesën definitive*".

22. Në një datë të paspecifikuar, pala e paditur Kompania e Sigurimeve "Elsig" paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur duke

pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Pala e paditur po ashtu kishte kërkuar që aktgjykimi i gjykatës themelore të prishet ose të kthehet në rivendosje ose të ndryshohet duke refuzuar në tërësi kërkesëpadinë në mungesë së përgjegjësisë dhe mos vërtetimit se shpenzimet janë krijuar si pasojë e aksidentit.

23. Më 5 nëntor 2018, Gjykata e Apelit (Aktgjykim Ae. nr. 240/2016) e refuzoi të pabazuar ankesën e palës së paditur Kompania e Sigurimeve "Elsig" dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë (III. C. nr. 150/2015 të 26 shtatorit 2016). Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenet 281 dhe 960 të LMD-së, për shkak se nga shkresat e lëndës dhe thëniet e palës së paditur rezulton se përgjegjës për dëmin e shkaktuar ka qenë i siguruari i palës së paditur. Gjykata e Apelit shtoi se parashtruesi i kërkesës ia ka paguar të siguruarit të saj kompensimin e dëmit të pësuar dhe se me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar tek parashtruesi i kërkesës.

24. Në pjesën relevante të aktgjykimit, Gjykata e Apelit kishte përcaktuar: "*Kjo gjykate vlerëson se gjykata e shkalles se pare drejte ka zbatuar te drejtën materiale respektivisht nenet 281 dhe 960 te LMD-se, për shkak se nga shkresat e lendes dhe nga thëniet e palës se paditur rezulton se përgjegjës për demin e shkaktuar ka qene i siguruari i te padituës. Paditësja ia ka paguar te siguruarit te saj kompensimin e demit te pësuar dhe me pagimin e kompensimit te gjitha te drejtat e te siguruarit kane kaluar te paditësja. Pretendimi ankimor se gjykata do te duhej ta zbatonte Nenin 269 te LMD-se, është i pabazuar sepse kjo dispozite i referohet natyrave tjera te sigurimit (sigurimi i jetës, sigurimi pasurisë nga fatkeqësitë, etj.) andaj është i pazbatueshëm ne rastin konkret*[...] *Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të së padituës, lidhur me lartësinë e normës së kamatës, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, ngase neni 26, pika 6, i Ligjit mbi Sigurimin e Detyruar nga Autopërgjegjësia, përcakton lartësinë e kamatës prej 12% nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka parashtruar pranë të padituës kërkesën për kompensim me datë 11 .03. 2014, dhe sipas dispozitës së cekur kamata rrjedh nga kjo datë, andaj, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale*".

25. Në një datë të paspecifikuar, pala e paditur Kompania e Sigurimeve "Elsig" paraqiti kërkesë për revizion të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës

kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të njëjtën ta prishë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

26. Më 27 shkurt 2019, Gjykata Supreme me Aktgjykim E.Rev.1/19, përcaktoi:

> "*(I) REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës KS "Elsig" në Prishtinë, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. Nr. 57/2013, datë 10.6.2014;*
>
> *(II) Pranohet revizioni i të paditurës vetëm sa i përket vendimit për kamatën e aprovuar, dhe ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.24/2016 datë 05.11.2018 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështjet Ekonomike III. C. Nr. 150/2015, i datës 26.09.2016, ashtu që në shumën e gjykuar në lartësi prej 80,03704 €, detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj me kamatën prej 8 %, duke filluar nga 11.03.2014 e tutje deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit*".

27. Gjykata Supreme vlerësoi se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale nga neni 382 i LMD-së në lidhje me nenin 26.7 të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia. Gjykata Supreme më tej arsyetoi se neni 26.7 i ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia, përjashton zbatimin e kamatës prej 12 % për regresim borxhi çka parashikon vetëm mos trajtimin dhe rënien në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim. Gjykata Supreme shtoi se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë vetëm në kamatëvonesë nga neni 382 i LMD-së por jo edhe kamatë të "kualifikuar "sipas dispozitave të zbatuara nga gjykatat e instancës më të ulët.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [E.Rev. 1/2019] të 27 shkurtit 2019 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të përcaktuara me neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

29. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës shton: "*Parashtruesi i Kërkesës konsideron se Aktgjykimi [E.Rev.Nr. 1/2019 i datës 27.02.2019] i Gjykatës Supreme karakterizohet nga mungesa*

e arsyetimit adekuat pasi Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetime të mjaftueshme dhe adekuate juridike kur ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ae. Nr. 240/2016 të datës 05.11.2018] lidhur me mënyrën e llogaritjes së kamatëvonesës në lëmin e sigurimit nga auto përgjegjësia (duke ndryshuar kështu qëndrimin e vetë Gjykatës Supreme ne raste identike lidhur me normën vjetore)".

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të kontestuar me këtë Kërkese nuk përcakton fare se mbi cilën bazë juridike Gjykata Supreme ka mbështetur vendimin e saj për ndryshimin e kamatëvonesës së gjykuar nga gjykata e instancës më të ultë. Parashtruesi konsideron se referimi në nenin 26 para 7 të Ligjit 04/L018 është jo-adekuat dhe rrjedhimisht arbitrar pasi dispozita e sipërpërmendur [Paragrafi 7] as që trajton këtë çështje, dhe, më së paku korrespondon me përmbajtjen e cituar në arsyetimin e Aktgjykimit [E.Rev.Nr. 1/2019 të datës 27.02.2019]*".

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme gabimisht i referohet paragrafit 7 të nenit 26 të Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia lidhur me lartësinë vjetore të kamatëvonesës, i cili, sipas parashtruesit të kërkesës, trajton diç krejtësisht tjetër në krahasim me atë çfarë Gjykata Supreme i referohet.

32. Parashtruesi i kërkesës konsideron: "*Aktgjykimi [E.Rev.Nr. 1/2019 i datës 27.02.2019 nuk mbështetet ne norme te caktuar juridike për përcaktimin e lartësisë se normës vjetore. Përderisa arsyetimi i Aktgjykimit te kontestuar trajton institutin e kamatëvonesës, nuk ofron arsye juridike kur përcakton lartësinë e normës vjetore te kamatëvonesës. Parashtruesi i sjell ne vëmendje Gjykatës Kushtetuese se tanimë ka një praktike afatgjate te Gjykatës Supreme te Kosovës qe parimisht instituti i kamatëvonesës ne lëmin e sigurimeve te detyrueshme vendoset mbi bazën e dispozitave te Ligjit 04/L-018 si ligj i veçantë "lex specialis*".

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*...në qëndrimin e dhënë në Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme nuk ka saktësuar se mbi cilën bazë juridike është mbështetur kur ka konstatuar se "kamata e aprovuar nga gjykatat e instancës më të ulët, ligjërisht nuk aplikohet ne kontestet për regresim borxhi por vetëm për vonesa të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblimin e dëmit në procedurë jashtëgjyqësore ashtu si parashihet me Nenin 26 të Ligjit në fjalë dhe Nenit 5.1 të BQK Rregullit Nr. 3 për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë të datës 25 shtator 2008*".

34. Lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe qëndrueshmërisë në vendimmarrje, parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Parashtruesi konsideron se me këtë Aktgjykim është cenuar edhe parimi i sigurisë juridike dhe i konsistencës në vendimmarrje. Kërkesa për qëndrueshmëri është thelbësore dhe kontribuon në trajtimin e barabartë të individëve që sjellin të njëjtat ose, në aspekte të rëndësishme, kërkesa të ngjashme në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës*".

35. Parashtruesi i kërkesës shton: "*Aktgjykimi i Gjykatës Supreme pra jo vetëm se ka mungesë të arsyetimit juridik por është edhe ne kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore, pasi referuar praktikës së saj gjyqësore në situata të njëjta rezulton se Gjykata Supreme me rastin e trajtimit të lartësisë vjetore të kamatëvonesës ka miratuar vendime të ndryshme*".

36. Në mbështetje të pretendimeve për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, parashtruesi i kërkesës i referohet rasteve nga jurisprudenca e GJEDNJ-së si për shembull, *Souminen kundër Finlandës*, *Tatishvili kundër Rusisë, Van de Hurk kundër Holandës*, etj. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i referohet vendimeve të Gjykatës, Rasti nr. KI87/8, *Parashtrues IF Skadeforsikring*, Aktgjykim i 15 prillit 2019; Rasti nr. KI97/16, Parashtrues IKK Classic, Aktgjykim i 11 janarit 2018.

37. Në mbështetje të pretendimeve për qëndrueshmëri në vendimmarrje dhe siguri juridike, parashtruesi i kërkesës i referohet disa vendimeve të Gjykatës Supreme: (1) [E.Rev. Nr. 27/2018 i datës 24 shtator 2018]; (2) [E.Rev.Nr.23/2017 i datës 14 dhjetor 2017], (3) [E.Rev.Nr.14/2016 i datës 24 mars 2016]; (4) [E.Rev.Nr. 6/2015 i datës 19.03.2015], (5) [E.Rev.Nr.62/2014 i datës 21 janar 2015], (6) [E.Rev.Nr. 20/2014 i datës 14 prill 2014]; (7) [E.Rev.Nr-48/2014 i datës 13 maj 2014], (8) [E.Rev.Nr.55/2014 i datës 3 nëntor 2014].

38. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës shton: "*Nga krahasimi i këtyre aktgjykimeve te Gjykatës Supreme rezulton se kjo Gjykate ka zbatuar ne vazhdimësi dhe ne mënyrë konsistente qëndrim te njëjtë juridik lidhur me përcaktimin e bazës juridike lidhur zbatimin e normës vjetore te kamatës. Andaj aktgjykimi [E.Rev.Nr. 1/2019 i dates 27.02.2019] i Gjykatës Supreme ne mënyrë tërësisht te kundërt i shmanget praktikes se deritanishme gjyqësore, pa dhënë ne asnjë rresht asnjë shpjegim se perse Gjykata largohet nga interpretimi i deritanishëm juridik lidhur me çështjen e njëjtë gjyqësore qe ka qene objekt shqyrtimi ne Gjykatën Supreme te Kosovës. Andaj kjo mungese e konsistencës se praktikes gjyqësore te instancës me te larte*

gjyqësore ne Republikën e Kosovës cenon ne mënyrë direkte parimin e sigurisë juridike të Parashtruesit".

39. Parashtruesi i kërkesës thekson: "*Parashtruesi konsideron se dështimi i Gjykatës Supreme të Kosovës që të përcaktoj bazën juridike lidhur me caktimin e lartësisë së kamatës vjetore në fushën e sigurimit nga auto përgjegjësia e shoqëruar me mungesë të arsyetimit juridik lidhur me devijimin nga praktika e deritanishme e Gjykatës Supreme në çështje të ngjashme përbën qartazi ndërhyrje në ushtrimin e së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 6 para 1 i KEDNJ-së lidhur me arsyetimin e vendimit gjyqësor*".

40. Në fund, Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: " *[...]pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve kushtetuese të Parashtruesit, të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E.Rev.Nr. 1/2019 të datës 27.02.2019] për shkak të shkeljes së nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E.Rev.Nr. 1/2019 të datës 27.02.2019] ta kthej për rishqyrtim*".

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE NR. 04/L-077

Neni 281
Subrogimi ligjor

Kur detyrimin e përmbush personi i cili ka ndonjë interes juridik në këtë çështje, atëherë i kalojnë këtij, në bazë të vet ligjit, në çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore.

NËNKREU 3

VONESA NË PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE NË TË HOLLA

Neni 382
Kamatëvonesa

1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën.

2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

NËNKREU 6

KALIMI I TË DREJTAVE TË SIGURUARIT NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS NË SIGURUESIN (SUBROGIMI)

Neni 960
Subrogimi

1. Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin.

2. Në qoftë se për faj të të siguruarit është bërë i pamundur ky kalim i të drejtave në sigurues tërësisht ose pjesërisht, siguruesi shkarkohet në masën përkatëse nga detyrimi i vet ndaj të siguruarit.

3. Kalimi i të drejtave nga i siguruari në sigurues nuk mund të jetë në dëmin e të siguruarit, kështu që në qoftë se shpërblimi të cilin e ka marrë i siguruari nga siguruesi për cilindo shkak qoftë është më i vogël nga sa është dëmi që ka pësuar, i siguruari ka të drejtë që prej pasurisë së personit përgjegjës t'i paguhet mbetja e kompensimit përpara kërkesës së siguruesit në bazë të të drejtave që janë kaluar në të.

4. Përjashtimisht nga rregullat mbi kalimin e të drejtave të të siguruarit në siguruesin, këto të drejta nuk kalohen në siguruesin, në qoftë se dëmin e ka shkaktuar personi në gjini në vijë të drejtë me të siguruarin, ose personi për sjelljet e të cilit përgjigjet siguruesi apo i cili bashkëjeton me të në të njëjtën ekonomi shtëpiake, ose personi që është punëtor i të siguruarit, përveç nëse këta persona e kanë shkaktuar dëmin me dashje.

5. Në qoftë se dikush nga personat e përmendur në paragrafin paraprak ka qenë i siguruar nga përgjegjësia, siguruesi mund të kërkojë nga siguruesi i tij kompensimin e shumës që i ka paguar të siguruarit.

LIGJI PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGJEGJËSIA NR. 04/L-018

Neni 26
Procedura e kërkesave për dëmshpërblim

1. Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me:

1.1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse;

1.2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit.

2. Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e kompletuar me prova dhe dokumentacion të nevojshëm për të vendosur për dëmshpërblimin, siguruesi është i detyruar që, më së largu në afat prej tri (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për dëmshpërblim, të njoftojë me shkrim të dëmtuarin duke precizuar me cilat nga provat dhe dokumentacioni duhet plotësuar kërkesën. Prej ditës së pranimit, respektivisht kompletimit të dokumentacionit të kërkesës, fillojnë të zbatohen afatet nga paragrafi 1. i këtij neni për detyrimin e siguruesit përkitazi me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.

3. BQK-ja nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e procedurave për dëmshpërblim, duke përfshirë edhe përcaktimin se kur konsiderohet e kompletuar kërkesa me prova dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vendosur lidhur me dëmshpërblimin.

4. Në pamundësi të përcaktimit të dëmit, respektivisht trajtimit të dëmshpërblimit në tërësi, siguruesi përgjegjës është i detyruar t'i paguajë palës së dëmtuar pjesën jokontestuese të dëmit në formë paradhënie, brenda afatit nga paragrafi 1. i këtij neni.

5. Në rast se siguruesi përgjegjës nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në Gjykatën Kompetente.

6. Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi

përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

7. Dispozitat nga paragrafi 1., 2., 4. dhe 5. të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në rastet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim të cilat janë detyrim i byrosë për dëmet nga baza e sigurimit kufitar dhe detyrimet e Fondit të kompensimit.

8. Në kërkesat për dëmshpërblim nga sistemi i kartonit ndërkombëtar të sigurimit zbatohen procedura dhe afate të posaçme sipas Marrëveshjes së Kretës.

Ligjit për Gjykatat Nr. 06/L-054, i cili në nenin 14 parasheh mekanizmin për administrimin e drejtë të drejtësisë dhe shqyrtimin e ndryshimit të praktikës gjyqësore.

Neni 14
Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryetarit dhe nënkryetarit të Gjykatës

"[...]
2.10. Kryetari i gjykatës thërret takim vjetor të të gjithë gjyqtarëve për këshillim mbi Administrimin e Drejtësisë në atë gjykatë; për të analizuar organizimin e gjykatës; për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika".

Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë miratuar nga Bordi Drejtues i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 25 shtator 2008

Neni 5
Rregullimi i dëmeve
5.1 Rregullimi

Kërkesat për zhdëmtim të bazuara në sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë në pajtim me dispozitat e kësaj rregulle, përfshirë regresin nga fondi garantues duhet të zgjidhen në një

periudhë kohore prej 10 ditësh prej ditës së parashtrimit të provave të nevojshme dhe dokumentacionit relevant që kërkohen nga kompania e sigurimit apo fondit garantues, duke iu referuar zhdëmtimit të dëmeve që kanë për pasojë vdekjen, lëndime trupore apo humbjen e pasurisë.

Fondi garantues apo një kompani e sigurimit e cila nuk rregullon dëmin valid Brenda periudhës kohore prej dhjetë (10) ditësh, duhet të paguaj dënimin e barabartë me 20% të kamatës vjetore të llogaritur nga data e raportimit të dëmit deri në datën kur zhdëmtimi është paguar apo rregulluar.

Mendim Juridik për Kamatën i miratuar në mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës i 1 dhjetorit 2020, i bazuar në nenin 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat

PJESA E PARË
Ligji i aplikueshëm

I. *Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85,57/89).*

II. *Për marrëdhëniet që kanë lindur pas datës 19.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012.*

PJESA E DYTË

IV. *Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore për të gjitha kërkesat caktohet si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar.*

V. *[...]*

VI. *Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 19.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore për të gjitha kërkesat do të caktohet në lartësi prej 8 %, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.*

IX. Për kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit nga të gjitha bazat e përgjegjësisë kur kreditorët kanë të drejtë në rimbursim të dëmit, lartësia e kamatës caktohet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik, varësisht se cili ligj është zbatuar (ka qenë në fuqi) kur kreditori në cilësinë e debitorit ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë.

Situatat kur aplikohet norma e interesit vjetor prej 12 %:

- *Kur kërkesat e paraqitura tek Kompanitë e Sigurimeve, për dëmin në persona, nuk trajtohen në afat prej 60 ditësh;*

- *Kur kërkesat e paraqitura tek Kompanitë e Sigurimeve, për dëmin në pasuri, nuk trajtohet brenda 15 ditësh;*

Arsyetimi i Mendimit Juridik

Arsyetimi për pikën IX (nëntë) të mendimit juridik- *Në praktikën gjyqësore paraqiten raste të shpeshta të kreditorëve për rimbursim të dëmit të cilët kanë përmbushur detyrimet paraprakisht ndaj palëve të treta, e të cilat kryesisht ndërlidhen me rastet e siguruara nga kompanitë e sigurimeve vendore me kompanitë e huaja. Për këtë lloj të kërkesave në praktikën e gjykatave është vërejtur interpretim dhe zbatim i dispozitave ligjore në disa forma sa i përket shkallës/lartësisë së kamatëvonesës për rastet e kërkesave për rimbursim. Kjo ka ndodhur për shkak se kreditorët me rastin e paraqitjes së kërkesave për rimbursim të dëmit duke iu referuar nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, kanë kërkuar që rimbursimi i kërkesës të bëhet me normë vjetore prej 12%, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës në Seancën e Përgjithshme të saj përmes këtij mendimi juridik ka vlerësuar se nuk mund të aplikohet norma/kamatëvonesa vjetore prej 12% në të gjitha rastet. Kjo për shkak se kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit kryesisht u referohen situatave për marrëdhëniet juridiko-civile (jokontraktuale për kreditorin dhe debitorin), prandaj, në një rast të tillë sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kamatëvonesa vjetore duhet të paguhet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik. Kjo nënkupton se në rast se kreditori ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë, para datës 20.12.2012, norma e interesit do të zbatohet si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, ndërsa në rast se kreditori ka përmbushur*

detyrimin ndaj palës së tretë pas datës 19.12.2012, atëherë shkalla/lartësia e kamatëvonesës do të zbatohet në shkallë prej 8%.

Përveç të cekurave Gjykata Supreme vlerëson se shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore prej 12%, nuk mund të zbatohet edhe për shkak të faktit se sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare me nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, interesi vjetor 12%, vjen në shprehje për shkak të neglizhencës së kompanive të sigurimeve (të cilat pastaj paraqiten si kreditor regresues), sepse sikur kreditorët regresues t'i kishin trajtuar konform përgjegjësive ligjore kërkesat e palëve të treta, ndaj tyre nuk do të mund të zbatohej shkalla/lartësia e kamatëvonesës prej 12%, në vendimet e gjykatës, por do të zbatohej shkalla/lartësia si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, apo shkalla/lartësia prej 8%, varësisht se cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e lindjes së marrëdhënies së detyrimit.

Pranueshmëria e kërkesës

41. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7, te nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë::

Neni 21
[Parimet e Përgjithshme]

"4. Te drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

Nenit 113
[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

43. Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të parashikuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

44. Në vlerësimin e përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë. (Shih, rastet e Gjykatës KI118/18, Parashtrues, *Eco Construction sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019, paragrafi 29; dhe KI41/09, Parashtrues, *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010,

paragrafi 14). Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E.Rev. 1/19], të 27 shkurtit 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të parashikuara me ligj.

45. Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E.Rev. 1/19] i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 14 mars 2019 derisa kërkesa nën shqyrtim është dorëzuar më 2 korrik 2019, pra, brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

46. Gjykata po ashtu konsideron se parashtruesi i kërkesës ka treguar saktësisht se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ janë shkelur në dëm të tij, në pajtim me kriteret e parashikuara neni 48 i Ligjit.

47. Prandaj, Gjykata vjen në përfundim se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike; se ka respektuar kushtin e dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor; ka sqaruar me saktësi shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe ka treguar cili është akti konkret i autoritetit publik që kontestohet.

48. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe argumentimit të tyre, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze kushtetuese dhe përcaktimi i tyre varet nga shqyrtimi i meritave të kërkesës. Po ashtu, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme (shih Gjykata Kushtetuese Rasti nr. KI97/16, *Parashtrues IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017).

49. Gjykata shpall kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita.

Meritat e kërkesës

50. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme shkelet e drejtat e tij për një vendim të arsyetuar çka ka shkaktuar edhe shkeljen e parimit për siguri juridike. Sipas parashtruesit të kërkesës, këto shkelje kanë ndodhur, sepse Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj nuk ka ofruar arsyetim të mjaftueshëm dhe adekuat për ndryshimin e

qëndrimit lidhur me llogaritjen e kamatëvonesës, qëndrimin të cilin deri atëherë e kishte zbatuar në mënyrë konsistente në praktikën e saj.

51. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se mbetet i pasqaruar dhe i paarsyetuar fakti se mbi cilën bazë juridike Gjykata Supreme e ka mbështetur aktgjykimin e saj për ndryshimin e kamatëvonesës së gjykuar nga gjykatat e instancës më të ulët.

52. Parashtruesi i kërkesës shton se në aktgjykimin e Gjykatës Supreme mungon arsyetimi përkatës për qasjen e re në këtë rast, lidhur me institutin e kamatëvonesës në raportet juridike të sigurimit të detyrueshëm nga auto-përgjegjësia, sepse në praktikën e deritanishme Gjykata Supreme kishte vendosur tërësisht ndryshe në raste të njëjta.

53. Duke pasur parasysh pretendimet e ngritura në kërkesën nën shqyrtim, Gjykata i referohet nenit 31 (1) dhe (2) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, që përcakton:

> *"1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*

54. Gjykata po ashtu i referohet nenit 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, që përcakton:

> *"Çdo person ka të drejtë që çështja* e *tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykate* e *pavarur dhe* e *paanshme, e krijuar* me *ligj,* e *cila* do *te vendose si për mosmarrëveshjet ne lidhje* me *te drejtat dhe detyrimet* e *tij te natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë* e *çdo akuze penale në ngarkim të tij."*

55. Gjykata rithekson se në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Rrjedhimisht, lidhur me pretendimet e ngritura për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet parimeve të

përgjithshme të përcaktuara nga jurisprudenca e konsoliduar e GJEDNJ-së.

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për vendim të arsyetuar

56. Gjykata, para së gjithash, rikujton se garancitë e përmbajtura në nenin 6 paragrafin 1 të KEDNJ-së përfshijnë detyrën e gjykatave që të bëjnë arsyetimin e vendimeve të tyre. Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë (shih rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës,* Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi).

57. Gjykata, gjithashtu, thekson se sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 6 paragrafi 1 i detyron gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga gjykatat të kërkohet përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës,* Aktgjykimi i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, Vendim për pranueshmëri, i 29 gushtit 2000).

58. Lidhur me këtë, GJEDNJ shton se gjykata vendore ka një liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e pretendimeve dhe në lejimin e provave, por ajo gjithashtu ka edhe obligimin që të justifikojë veprimet e saj duke dhënë arsyetime për vendimet e saj (shih rastin e GJEDNJ-së, *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003, paragrafi 36).

59. Gjithashtu, Gjykata thekson se në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, gjatë shqyrtimit nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i plotëson standardet e të drejtës për gjykim të drejtë, duhet të merren parasysh rrethanat e rastit konkret. Vendimi gjyqësor nuk duhet të jetë pa asnjë arsyetim, as arsyetimi nuk duhet të jetë i paqartë. Kjo posaçërisht vlen për arsyetimin e vendimit të gjykatës e cila vendos sipas mjetit juridik, në të cilin janë ndryshuar qëndrimet juridike të paraqitura në vendimin e gjykatës më të ulët (shih, *Van de Hurk kundër Holandës,* cituar më lart, paragrafi 61).

60. Gjykata dëshiron të theksojë se nocioni i një gjykimi të drejtë, në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, gjithashtu kërkon që gjykata kombëtare e cila ka dhënë arsye të pakta për vendimet e saj, në të vërtetë të ketë adresuar çështjet themelore në kuadër të juridiksionit të saj, pra se nuk i kishte pranuar thjeshtë dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët. Kjo kërkesë është edhe

më e rëndësishme në rast kur një palë në kontest nuk ka pasur mundësi për të paraqitur gojarisht rastin e saj në procedurën vendore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Helle kundër Finlandës,* Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60).

61. Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe reflektimeve kur shqyrtohet prova e propozuar, nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI 97/16 *IKK Classic*, Aktgjykimi i 11 janarit 2018).

(ii) Parimet e përgjithshme lidhur me sigurinë juridike dhe qëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore

62. GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore ka përcaktuar se nuk është funksioni i saj të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë vendore, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me KEDNJ (shih *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28). Po ashtu, nuk është funksioni i saj as t'i krahasojë, përveç në rastet e arbitraritetit të dukshëm, vendimet e ndryshme të gjykatave kombëtare, madje edhe nëse ato janë nxjerrë në procedurat që janë dukshëm të ngjashme, pasi që pavarësia e këtyre gjykatave duhet të respektohet (shih rastin e GJEDNJ-së *Ādamsons kundër Letonisë*, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118).

63. Mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor të bazuar mbi rrjetin e gjykatave themelore dhe të apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial. Një shmangie e tillë mund të ndodhë edhe brenda të njëjtës gjykatë. Kjo, në vetvete, nuk mund të konsiderohet e kundërt me KEDNJ-në (shih rastet e GJEDNJ-së, *Santos Pinto kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41; dhe *Tudor Tudor kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 29).

64. Megjithatë, GJEDNJ në praktikën e saj ka vendosur kritere të cilat ajo i përdor për të vlerësuar nëse vendimet kundërthënëse (devijimet nga praktika) të gjykatave vendore, duke gjykuar në instancën e fundit, shkelin kriteret për gjykim të drejtë të parashikuar me nenin 6

paragrafi 1 të KEDNJ-së, e ato kritere janë: ***(i)*** *përcaktimi nëse ekzistojnë "dallime të thella dhe afatgjata" në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit,* ***(ii)*** *nëse ligjet e vendit parashohin një mekanizëm i cili mund t'i tejkalojë këto kundërthënie,* ***(iii)*** *nëse ky mekanizëm është zbatuar dhe, nëse po, deri në çfarë mase* (shih rastet e GJEDNJ-së, *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët. 49-50; *Beian kundër Rumanisë* (nr. 1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, par. 34-40; *Ştefan dhe Ştef kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 27 janarit 2009, par. 33-36; *Schwarzkopf dhe Taussik kundër Republikës Çeke,* Vendim për pranueshmëri, i 2 dhjetorit 2008; *Tudor Tudor*, i cituar më lart, paragrafi 31; dhe *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 2 nëntorit 2010, paragrafi 36).

(iii) Zbatimi i parimeve të përgjithshme për vendim të arsyetuar dhe siguri juridike në rrethanat faktike të rastit konkret

65. Gjykata vëren se pretendimi kryesor ankimor i parashtruesit të kërkesës është se Gjykata Supreme nuk kishte dhëne arsye të qarta dhe të mjaftueshme mbi të cilat e ka mbështetur vendimin e saj për ndryshimin e aktgjykimeve të gjykatave të shkallës më të ulët, lidhur me llogaritjen e lartësisë së kamatëvonesës në rastin e parashtruesit si dhe duke mos arsyetuar se përse kishte nxjerrë një vendim të ndryshëm në krahasim me praktikën e saj të mëparshme kishte cenuar parimin e sigurisë juridike të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së.

66. Gjykata konsideron se në rastin konkret pretendimet për një vendim të arsyetuar dhe siguri juridike, për shkak të natyrës së rastit dhe ndërlidhjes së tyre, duhet të shqyrtohen në kuadër të një arsyetimi të vetëm. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme (Aktgjykim E.Rev. 1/19) pranoi revizionin e të paditurës vetëm sa i përket vendimit për kamatën e aprovuar dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit (Ae. nr. 240/2016 të 5 nëntorit 2018) dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (III. C. nr. 150/2015 të 26 shtatorit 2016).

67. Në lidhje me këtë Gjykata Supreme theksoi: "*(I) REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës KS "Elsig" në Prishtinë, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. Nr. 57/2013, datë 10.6.2014; (II) Pranohet revizioni i të paditurës vetëm sa i përket vendimit për kamatën e aprovuar, dhe ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.24/2016 datë 05.11.2018 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështjet Ekonomike III. C. Nr. 150/2015, i datës 26.09.2016, ashtu që në shumën e gjykuar në lartësi prej 80,03704 €, detyrohet e paditura*

që paditëses t'ia paguaj me kamatën prej 8 %, duke filluar nga 11.03.2014 e tutje deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit".

68. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se për të mbështetur pretendimin e tij për cenim të parimit të sigurisë juridike, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar tetë (8) vendime të Gjykatës Supreme në raste të ngjashme ku janë trajtuar çështjet e regresimit të borxhit dhe të kamatëvonesës: (1) [E.Rev. Nr. 27/2018 i datës 24 shtator 2018]; (2) [E.Rev.Nr.23/2017 i datës 14 dhjetor 2017], (3) [E.Rev.Nr.14/2016 i datës 24 mars 2016]; (4) [E.Rev.Nr. 6/2015 i datës 19.03.2015], (5) [E.Rev.Nr.62/2014 i datës 21 janar 2015], (6) [E.Rev.Nr. 20/2014 i datës 14 prill 2014]; (7) [E.Rev.Nr-48/2014 i datës 27 tetor 2014], (8) [E.Rev.Nr.55/2014 i datës 3 nëntor 2014].

69. Në vijim, Gjykata do të riprodhojë pjesët relevante të disa prej vendimeve të lartpërmendura.

70. Në Aktgjykimin E.Rev.nr. 20/2014 të 14 prillit 2014, Gjykata Supreme në pjesën relevante kishte arsyetuar: "*Edhe thëniet e te paditurës ne revizion se gjykatat e instancës me te ulet gabimisht kane aplikuar te drejtën materiale kur paditëses i kane pranuar te drejtën me kamate ne lartësinë e shumes se aprovuar ne lartësi prej 12% vjetore janë te pabazuara, ngase gjykatat e instancës me te ulet drejt kane aplikuar te drejtën materiale dhe atë dispozitën të nenit 277 të LMD-së lidhur me nenin 26 pika 6 te Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia nr. 04/L-018 me të cilën dispozite është paraparë se në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në parag.1. të këtij neni, dhe mos përmbushjes se detyrimit ne pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni ,siguruesi përgjegjës konsiderohet te jete ne vonese ne përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim ,duke u ngarkuar me pagese të interesit për vonese. Ky interes paguhet ne lartësi prej 12% te interesit vjetor dhe llogaritet për çdo dite vonese deri ne shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës duke filluar nga data e paraqitjes se kërkesës për dëmshpërblim*".

71. Në Aktgjykimin E. Rev. nr. 62/2014 të 21 janarit 2015, Gjykata Supreme në pjesën relevante kishte arsyetuar: "*Kjo Gjykatë vlerëson së gjykata e shkallës së dytë drejt ka aplikuar të drejtën materiale kur të paditurës ia ka pranuar të drejtën në kamatë në shumën e borxhit kryesor në lartësi prej 12% duke ia llogaritur nga data 14.6.2010 deri në pagesën definitive ngase sipas dispozitës së nenit 277 të LMD e lidhur me nenin 26.6 të Ligjit për Sigurimin te Detyrueshëm nga autopërgjegjësia nr. 04/L-018, parashihet kamata ne lartësi prej 12% në vit e cila llogaritet për çdo ditë vonese deri në shlyerjen e*

dëmshpërblimit nga siguruesi, duke llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim".

72. Në Aktgjykimin e E.Rev. 23/2017 të 14 dhjetorit 2017, Gjykata Supreme në pjesën relevante kishte arsyetuar: "*Kjo lartësi e kamatës ka qene e parapare deri ne hyrje ne fuqi te ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia (nr. 04/L-018) e cila ka hyrë në fuqi me 30.07.2011 dhe kjo datë duhet të llogaritet kamata prej 12 % në bazë të nenit 26. pika 6. Gjykata e shkallës së dytë ka llogaritur kamatën në shumën e gjykuar në lartësi që paguajnë bankat në mjetet e deponuara mbi një viti pa destinim të caktuar si dhe kamatën në bazë të Rregullit 3 të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) dhe ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia*".

73. Në Aktgjykimin E.Rev.Nr.55/2014 të 3 nëntorit 2014, Gjykata Supreme n1% pjesën relevante kishte arsyetuar: *"Me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.46/2013 të datës 10.05.2014 është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë C.nr.282/2012 të datës 09.10.2012 me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që të paguaj në emër të borxhit regresiv shumën prej 14,041,58 € me kamatë vjetore 12% [...] Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur, sipas dispozitës së nenit 215 të LPK, vlerësoi se: Revizioni është i pabazuar"* .

74. Në Aktgjykimin E.Rev. nr.48/2014 të 27 tetorit 2014, Gjykata Supreme në pjesën relevante kishte arsyetuar: *"Kjo Gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë aplikuar edhe të drejtën materiale kur paditëses i kanë pranuar të drejtën në kamatë në shumën e borxhit kryesor në lartësi prej 20% vjetore duke filluar nga data 19.11.2010 e deri me datën 28.07.2011 dhe kamatën prej 12% duke filluar nga 29.07.2011 e deri në pagesën definitive ngase sipas dispozitës 277 të LMD si dhe nenit 26.6 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia nr. 04/L-018 me të cilën dispozitë është paraparë se në rastin e mosrespektimit të afateve nga paragrafi 1 të këtij neni, mos përmbushja së pagesës në paradhënies nga paragrafi 4 i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë me vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke e ngarkuar me pagesë të interesit në vonesë, ky interes paguhet në lartësinë prej 12% të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim".*

75. Në Aktgjykimin E. Rev. nr. 6/2015, të 19 marsit 2015, Gjykata Supreme në pjesën relevante kishte arsyetuar: *"Me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.162/2013, datë 10.06.2014, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës, dhe është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje ekonomike C.nr.339/2019 datë 16.07.2013, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, dhe është detyruar e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën prej 17,924, 35€, në emër të kompensimit të dëmit-kasko regres lidhur me riparimin e automjetit të dëmtuar të tipit "BMW 5" me targa ES VS 2009, në aksidentin e datës 25.08.2009, pronar i të cilit ishte VJ i cili kishte siguruar këtë automjet me sigurim kasko tek e paditura, me kamatë ndëshkuese prej 12% duke filluar nga data 22.07.2010 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,134,29 € [...] Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e shkallës së dytë të goditur me revizion, në kuptim të nenit të Ligjit për procedurë Kontestimore (LPK), dhe gjeti se: Revizioni i të paditurës është i pabazuar".*

76. Në Aktgjykimin E.Rev.nr. 14/2016 të 24 marsit 2016, Gjykata Supreme në pjesën relevante kishte arsyetuar: *"Me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.40/2015 datë 11.12.2015, është refuzuar si i pabazuar ankesa e të paditurës ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje ekonomike, C.nr.544/2013, datë 23.12.2014, me të cilën me pjesën I të dispozitivit është miratuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit që të detyrohet Kompania e Sigurimeve "Insig" me seli në Prishtinë, që paditësit t'ia kompensojë shumën 42,243.41€, në emër të regresit nga sigurimi i auto përgjegjësisë me kamatë prej 12% në vit duke e llogaritur nga data 14.1.2010 e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi [...] Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se: Revizioni është i pabazuar"* .

77. Në Aktgjykimin E.Rev.nr.27/2018 të 24 shtatorit 2018, Gjykata Supreme në pjesën relevante kishte arsyetuar: *"Ndërkohë që, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, përkitazi me kamatën e gjykuar, është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndaj, edhe e ndryshoi të njëjtin në këtë pjesë, duke e lënë në fuqi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Kështu, nga se. Gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar drejtë të drejtën materiale kur paditësit i ka pranuar të drejtën në kamatë në lartësi prej 20% duke filluar nga dt.24.11.2011, e deri me dt.29.07.2011 dhe kamatën prej 12% duke filluar nga dt.29.07.2011 e deri në pagesën definitive ngase sipas dispozitës së nenit 277 të LMD dhe nenit 26.6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga*

Autopërgjegjësia, me të cilën dispozitë është paraparë se në rastin e mosrespektimit të afateve të përcaktuara në par.1 të këtij neni dhe mos përmbushjen e detyrimit në pagesën e paradhënies së par.4 të këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke e ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë, ky interes paguhet në lartësi prej 12% të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim".

78. Nga sa më sipër, Gjykata do të shërbehet me testin e përcaktuar nga jurisprudenca e GJEDNJ-së që përcakton: (i) nëse ekzistojnë "dallime të thella dhe afatgjata" në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit, (ii) nëse ligjet e vendit parashohin një mekanizëm i cili mund t'i tejkalojë këto kundërthënie, (iii) nëse ky mekanizëm është zbatuar dhe,(iv) nëse vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme plotëson kushtin për një vendim të arsyetuar në pajtim me jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe të kësaj Gjykate.

79. Gjykata sërish i referohet Ligjit për Gjykatat Nr. 06/L-054, i cili në nenin 14 parasheh mekanizmin për administrimin e drejtë të drejtësisë dhe shqyrtimin e ndryshimit të praktikës gjyqësore.

Neni 14
Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryetarit dhe nënkryetarit të Gjykatës

"[...]
2.10. Kryetari i gjykatës thërret takim vjetor të të gjithë gjyqtarëve për këshillim mbi Administrimin e Drejtësisë në atë gjykatë; për të analizuar organizimin e gjykatës; për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika".

80. Gjykata thekson se në praktikën e saj gjyqësore në shumë raste ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit janë brenda fushëveprimit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë antikushtetuese (shih, mes tjerash, Gjykata Kushtetuese Rasti nr. KI33/16, *Parashtruese Minire Zeka*, Aktgjykim i 4 gushtit 2018, paragrafi 91).

81. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme është instanca e fundit dhe më e larta e gjyqësorit të rregullt, dhe si e tillë, ajo duhet të kujdeset për harmonizimin e praktikës gjyqësore në Republikën e Kosovës si

dhe administrimin e drejtë të drejtësisë. Është obligim i Gjykatës Supreme që në rastet që janë të ngjashme në mënyrë relevante, për aq sa është e mundur, që vendimet e saj të jenë të parashikueshme dhe të karakterizohen nga rregullsia e rezultateve. Parashikueshmëria dhe rregullsia e vendimeve të Gjykatës Supreme do të ishte njëlloj në dobi të ankuesve dhe gjykatave të instancës më të ulët.

82. Gjykata vëren se Gjykata Supreme në aktgjykimin e kontestuar ka përcaktuar: (i) se dispozitat ligjore relevante për rastin e parashtruesit të kërkesës janë neni 382 i LMD-së në lidhje me nenin 26.7 të Ligjit për Autopërgjegjësinë; (ii) se kamata prej 12 % nuk zbatohet në rastet për regresim të borxhit por vetëm në kërkesat e trajtimit të personave të dëmtuar për shpërblim të dëmit në procedurë jashtëgjyqësore; (iii) se kamata prej 12% zbatohet vetëm për mos trajtim dhe rënie në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim dhe jo për regresim borxhi; dhe, se (iv) për këto arsye, parashtruesit të kërkesës ka të drejtë në kamatëvonesë të paraparë me nenin 382 të LMD-së (8%) dhe jo kamatë të "kualifikuar" (12%).

83. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet pjesës relevante të aktgjykimit të Gjykatës Supreme, që përcakton: *"...aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë lidhur me pjesën që ka të bëjë me kamatën e gjykuar përfshihet me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga neni 382 i LMD-së në lidhje me nenin 26.7 të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia [...] zbatimi i gabuar i të drejtës materiale qëndron në faktet se siç është thënë më lartë, kërkesëpadia e paditësit për shpërblim të dëmit si dhe padia është paraqitur në kohën kur ka hyrë në fuqi për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia. Kamata e aprovuar nga gjykatat e instancës më të ulët, ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për regresim të borxhit por vetëm në kërkesat e trajtimit të personave të dëmtuar për shpërblim të dëmit në procedurën jashtëgjyqësore ashtu siç parashihet në nenin 26 të Ligjit në fjalë dhe nenit 5.1 të Rregullit të BQK-së nr. 3 mbi ndryshimin e Rregullit për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia të datës 25 shtator 2008, në të cilat dispozita thirren gjykatat e instancës më të ulët. Ato kamata të cilat i kanë aplikuar gjykata shkallës së parë dhe të dytë janë të parapara me qëllim të disiplinimit të kompanive të siguruese në raportet e sigurimit ndaj kërkesave për dëmshpërblim të personave të dëmtuar të cilat kërkesa kompanitë sigurimeve janë të detyruara që t'i trajtojnë me urgjencë brenda afateve të parapara sipas dispozitave të lartpërmendura. Par. 7 i nenit 26 të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia, përjashtim zbatimin e kamatës prej 12 % për regresim borxhi, kamatë kjo vetëm e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënien në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar*

për dëmshpërblim. Nga kjo rezulton se paditësi ka të drejtë vetëm në kamatëvonesë të paraparë me nenin 382 nga LMD dhe jo kamatë "të kualifikuar" sipas dispozitave të zbatuara nga gjykata e shkallës së parë dhe të dytë. Meqenëse, paditësja me parashtresën e datës 11.3.2014 ka kërkuar regresim të borxhit nga e paditura, rezulton se e paditura nga kjo datë ka rënë në vonesë kur nuk e ka përmbushur detyrimin brenda afatit deri në pagesën definitive".

84. Çështja nëse parashtruesit të kërkesës i njihet e drejta për 12 % ose 8 % të kamatëvonesës është çështje e zbatimit dhe interpretimit të ligjit dhe e diskrecionit në gjykim të Gjykatës Supreme, dhe si të tilla, në vetvete, nuk bien ndesh me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përveç nëse rezulton se ka shkelje flagrante të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, çfarë është e qartë se nuk ka ndodhur në rastin nën-shqyrtim.

85. Sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme ka dhënë bazën juridike dhe ka shpjeguar se në cilat raste zbatohet norma ligjore që përcakton kamatëvonesën prej 12% respektivisht 8% dhe përse në rastin e parashtruesit të kërkesës zbatohet norma që përcakton kamatëvonesën prej 8%. Në aktgjykimin e kontestuar të Gjykatë Supreme ekziston lidhja logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe konkluzave të nxjerra çka nënkupton se aktgjykimi i kontestuar i përmban të gjithë komponentët e një vendimi të arsyetuar.

86. Lidhur me qëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore, bazuar në testin e trefishtë të përcaktuar nga GJEDNJ-ja, Gjykata konstaton: (i) se në rastin nën shqyrtim nuk është provuar ekzistenca dallimeve "të thella dhe afatgjate" lidhur me qëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme; (ii) se ekziston mekanizmi për administrimin e drejtë të drejtësisë dhe për shqyrtimin e ndryshimit të praktikës gjyqësore (shih Ligji për Gjykatat Nr. 06/L-054, neni 14. 2.10); dhe se; (iii) Gjykata Supreme më 1 dhjetor 2020 ka nxjerrë "Mendim Juridik për Kamatën lidhur me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes" bazuar në nenin 14. 2.10 të Ligjit për Gjykatat.

87. Në këtë drejtim, Gjykata nënvizon se neni 31 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së nuk akordon të drejtën e fituar për qëndrueshmëri *(consistency)* të praktikës gjyqësore. Zhvillimi i praktikës gjyqësore, në vetvete, nuk është kundër administrimit të drejtë të drejtësisë pasi që dështimi për të mbajtur qasje dinamike dhe evolutive do të pengonte reformën apo përmirësimin (shih rastet e GJEDNJ-së, *Nejdet Şahin and Perihan Şahin kundër Turqisë*, Aktgjykim i 20 tetorit 2010, paragrafi 58; (*Lupeni Greek Catholic Parish and Other v. Romania) Famullia Katolike Greke dhe të tjerët*

kundër Rumanisë, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 116). Dallimet në praktikë gjyqësore , për nga natyra, janë pasojë e qenësishme të cilitdo sistemi gjyqësor që është i bazuar në një rrjet të gjykatave të faktit dhe të apelit me autoritet mbi zonën e juridiksionit territorial të tyre. Roli i Gjykatës Supreme është që pikërisht t'i zgjidhë konfliktet e tilla (shih rastin e GJEDNJ-së, *Beian kundër Rumanisë* (nr. 1), cituar më lart, paragrafi 37).

88. Lidhur me vendimet e Gjykatës Supreme që i ka dorëzuar parashtruesi i kërkesës me qëllim të ilustrimit të qëndrimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme dhe të krahasimit me aktgjykimin e kontestuar në rastin nën shqyrtim, Gjykata thekson se nuk është funksioni i saj që t'i krahasojë ato vendime me aktgjykimin e kontestuar, përveç në rastet e arbitraritetit të dukshëm, çfarë nuk ka ngjarë në rrethanat e rastit konkret, sidomos duke pasur parasysh respektimin e pavarësisë të gjykatave të rregullta (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Adamsons kundër Letonisë*, të cituar më lart, paragrafi 118).

89. Nga sa më sipër, Gjykata përfundon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është në përputhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe parimin e sigurisë juridike sepse: (i) shpjegon se kamata prej 12% zbatohet vetëm për mos trajtim dhe rënie në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim dhe jo për regresim borxhi; (ii) parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në kamatëvonesë të paraparë me nenin 382 të LMD-së në lartësi prej 8% dhe jo kamatë të "kualifikuar" në lartësi prej 12% dhe, se (iii) Gjykata Supreme më 1 dhjetor 2020 ka nxjerrë "Mendim Juridik për Kamatën lidhur me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes" bazuar në nenin 14. 2.10 të Ligjit për Gjykatat.

90. Prandaj, Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përfundim

91. Lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata Supreme (i) ka dhënë bazën juridike dhe ka shpjeguar se përse në rastin e parashtruesit të kërkesës zbatohet norma që përcakton kamatëvonesën prej 8%; (ii) aktgjykimi i kontestuar i Gjykatë Supreme përmban lidhje logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe konkluzave të nxjerra; (iii) si rrjedhojë logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe konkluzave ka rezultuar se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme plotëson kushtin e një vendimi të arsyetuar; dhe, se (iv) nëse parashtruesit të kërkesës i

njihet e drejta për 12 % ose 8 % të kamatëvonesës është çështje e zbatimit dhe interpretimit të ligjit dhe e diskrecionit në gjykim të Gjykatës Supreme, dhe si të tilla, në vetvete, nuk bien ndesh me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

92. Lidhur me pretendimin për cenim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata konstatoi: (i) se në rastin nën shqyrtim nuk është provuar ekzistenca dallimeve "të thella dhe afatgjate" lidhur me qëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme; (ii) se ekziston mekanizmi për administrimin e drejtë të drejtësisë dhe për shqyrtimin e ndryshimit të praktikës gjyqësore (shih Ligji për Gjykatat Nr. 06/L-054, neni 14. 2.10); (iii) Gjykata Supreme më 1 dhjetor 2020 ka nxjerrë "Mendim Juridik për Kamatën lidhur me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes" bazuar në nenin 14. 2.10 të Ligjit për Gjykatat (iv) se mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor të bazuar mbi rrjetin e gjykatave themelore dhe të apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial; (v) se cili ligj duhet zbatuar në rrethanat e rastit konkret është prerogativë dhe detyrë e Gjykatës Supreme; dhe, se (v) roli i Gjykatës Supreme është që pikërisht t'i zgjidhë konfliktet e tilla.

93. Në fund, Gjykata konstatoi se, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 prill 2021,

VENDOS

I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, E. Rev. nr. 1/2019, i 27 shkurtit 2019, është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

IV. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Remzije Istrefi-Peci	Arta Rama-Hajrizi

KI235/19, Parashtrues i kërkesës: Kompania e Sigurimeve "Allianz Suisse Versicherungs- Gesellschaft AG" Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 32/2019], të 31 korrikut 2019

KI235/19, Aktgjykim i miratuar më 28 prill 2021, publikuar më 16 qershor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, konsistenca e praktikës gjyqësore, siguria juridike, e drejta për vendim të arsyetuar*

Rrethanat e këtij rastit, ndërlidhen me një aksident të vitit 2009, në të cilin, e siguruara e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht Sh.Z., kishte humbur jetën. Përgjegjësia për aksident kishte rënë mbi H.K.-në, i siguruar i BKS-së, i cili ishte dënuar për veprën penale rrezikim i trafikut publik në vitin 2010. Parashtruesi i kërkesës e kishte kompensuar familjen e të ndjerës në shumën prej 36,000.00 euro. Përkitazi me këtë shumë në vitin 2015, parashtruesi i kërkesës iu drejtua BKS-së me kërkesë për kompensim mbi bazën e të drejtës në subrogim të përcaktuar përmes LMD-së, dhe në mungesë të një marrëveshjeje, iu drejtua Gjykatës Themelore përmes padisë. Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, i kishin dhënë të drejtë parashtruesit të kërkesës, duke konfirmuar detyrimin e BKS-së që të kompensojë parashtruesin e kërkesës në vlerën e lartcekur dhe gjithashtu detyrimin për të paguar kamatën prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, duke filluar nga 5 qershori 2015 deri në pagesën definitive. Gjykata Supreme gjithashtu përfundimisht kishte konfirmuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës në kompensimin përkatës mbi bazën e subrogimit, por kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore edhe asaj të Apelit, përkitazi me kamatëvonesën. Gjykata Supreme, kishte përcaktuar që kamata vjetore duhet të jetë tetë përqind (8%) në vit, bazuar në nenin 382 të LMD-së dhe jo dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, siç kishin vendosur gjykatat e shkallës më të ulët. Këtë konstatim të Gjykatës Supreme, përkitazi me lartësinë e kamatvonesës, parashtruesi i kërkesës e konteston para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KENDJ-së, për shkak të (i) cenimit të parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës Supreme; dhe (ii) mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor.

Gjykata vlerësoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me sigurinë juridike dhe të drejtën për vendim të arsyetuar, si një ndër garancitë e përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, duke mbështetur këtë vlerësim në praktikën gjyqësore të

Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ).Gjykata shtjelloi parimet e përgjithshme që burojnë nga GJEDNJ-ja dhe praktika e saj gjyqësore përkitazi me konsistencën gjyqësore dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar.

Lidhur me pretendimin për cenim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata konstatoi: (i) se në rastin nën shqyrtim nuk është provuar ekzistenca e dallimeve "të thella dhe afatgjate" lidhur me qëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme; (ii) se ekziston mekanizmi për administrimin e drejtë të drejtësisë dhe për shqyrtimin e ndryshimit të praktikës gjyqësore; (iii) Gjykata Supreme më 1 dhjetor 2020 ka nxjerrë "Mendim Juridik për Kamatën lidhur me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes" bazuar në nenin 14. para. 2. pika 10 të Ligjit për Gjykatat; (iv) se mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor të bazuar mbi rrjetin e gjykatave themelore dhe të apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial; (v) se cili ligj duhet zbatuar në rrethanat e rastit konkret është prerogativë dhe detyrë e Gjykatës Supreme; dhe, se (v) roli i Gjykatës Supreme është që pikërisht t'i zgjidhë konfliktet e tilla.

Lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata Supreme (i) ka dhënë bazën juridike dhe ka shpjeguar se përse në rastin e parashtruesit të kërkesës zbatohet norma që përcakton kamatëvonesën prej 8%; (ii) aktgjykimi i kontestuar i Gjykatë Supreme përmban lidhje logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe konkluzave të nxjerra; (iii) si rrjedhojë logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe konkluzave ka rezultuar se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme plotëson kushtin e një vendimi të arsyetuar; dhe, (iv) nëse parashtruesit të kërkesës i njihet e drejta për 12 % ose 8 % të kamatëvonesës është çështje e zbatimit dhe interpretimit të ligjit dhe e diskrecionit në gjykim të Gjykatës Supreme, dhe si të tilla, në vetvete, nuk bien ndesh me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Në fund, Gjykata konstatoi se, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI235/19

Parashtrues

"Allianz Suisse Versicherungs- Gesellschaft AG"

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës E.Rev.nr.32/2019, të 31 korrik 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga kompania e sigurimeve "*Allianz Suiss Versicherungs- Gesellschaft AG*" me seli në Cyrih të Zvicrës, e përfaqësuar nga ICS Assistance LL.C., përmes Besnik Z. Nikqit, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E.Rev.nr.32/2019] të 31 korrikut 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ae.nr.289/2017] e 31 janarit 2019 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [I.C.nr.238/2015] e 31 tetorit 2017 të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 21 gusht 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 (Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 20 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 30 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.

8. Më 20 janar 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi autorizimin për përfaqësim.

9. Më 3 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës, dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.

10. Më 4 shkurt 2020, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj.

11. Më 22 tetor dhe 24 nëntor 2020, respektivisht, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Supreme, përkitazi me një numër rastesh të dorëzuara në Gjykatë e të cilat kontestojnë Aktgjykime të Gjykatës Supreme për sa i përket përcaktimit të kamatëvonesës në rastet e kërkesave për kompensim të dëmit në bazë të së drejtës për subrogim si rezultat i aksidenteve të trafikut të shkaktuara në Republikën e Kosovës. Duke sqaruar se rastet respektive para Gjykatës, ndër të tjera, kontestojnë, cenimin e sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme në raste të ngjashme, Gjykata kërkoi sqarim nëse (i) Gjykata Supreme ka nxjerrë një qëndrimi parimor në lidhje me kompensimin e dëmit dhe caktimit të kamatëvonesës përkitazi me kërkesat në kuadër të së drejtës në subrogim; dhe nëse ky nuk është rasti (ii) të njoftohet Gjykata përkitazi me praktikën e Gjykatës Supreme, se në cilat raste zbatohet neni 382 (Kamatëvonesa) i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet Detyrimore (në tekstin e mëtejmë: LMD) dhe në cilat raste zbatohet paragrafi 6 i nenit 26 (Procedura e kërkesave për dëmshpërblim) të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (në tekstin e mëtejmë: Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm).

12. Më 18 nëntor 2020, Gjykata (i) kërkoi nga Gjykata Themelore dosjen e plotë të lëndës; dhe (ii) njoftoi Byronë Kosovare të Sigurimit (në tekstin e mëtejmë: BKS) për regjistrimin e kërkesës dhe i mundësojë të njëjtës dorëzimin e komenteve, nëse ka, në Gjykatë.

13. Më 19 nëntor 2020, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës.

14. Më 1 dhjetor 2020, Gjykata Supreme (i) para Gjykatës sqaroi çështjet e ngritura përmes shkresës së lartcekur; dhe (ii) dorëzoi në Gjykatë Mendimin Juridik për Kamatën të 1 dhjetorit 2020 të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme).

15. Më 28 prill 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese Gresa Caka-Nimani dhe, njëzëri, i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe vlerësimin e çështjes në merita.

16. Të njëjtën ditë, Gjykata votoi, njëzëri, që kërkesa është e pranueshme; por me shumicë votash, konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

17. Në të njëjtën datë, Gjyqtarja raportuese në bazë të paragrafit (4) të rregullit 58 (Këshillimet dhe Votimi) të Rregullores se punës, duke marrë parasysh që nuk ishte në mesin e shumicës se gjyqtarëve që konstatuan si më sipër, kërkoi nga Kryetarja e Gjykatës që të caktohet një gjyqtar tjetër, nga shumica, për të përgatitur Aktgjykimin pa shkelje kushtetuese.

18. Në të njëjtën datë, në bazë të rregullit të lartcekur, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, si njërin nga gjyqtaret e Kolegjit shqyrtues, për të përgatitur Aktgjykimin pa shkelje kushtetuese.

19. Më 2 qershor 2021, gjyqtari Safet Hoxha prezantoi Aktgjykimin para Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve

20. Më 16 shtator 2009, Sh.Z., e cila ishte e siguruar nga parashtruesi i kërkesës, kishte humbur jetën si pasojë e një aksidenti komunikacioni të shkaktuar nga H.K., i cili ishte i siguruar nga BKS. Familja e Sh.Z.-së, ishte kompensuar nga parashtruesi i kërkesës në shumën prej 36,000.00 euro.

21. Bazuar në shkresat e lëndës gjithashtu rezulton se (i) BKS dhe familja e Sh.Z.-së kishin arritur një ujdi jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial lidhur me aksidentin e lartcekur në shumën prej 27,000 euro; (ii) më 10 mars 2015, parashtruesi i kërkesës iu drejtua BKS-së, që mbi bazën e të drejtës në subrogim të përcaktuar përmes nenit 280 (Përmbushja me bartjen e të drejtës në përmbushësin (subrogimi)) të LMD-së, t'i rimbursohet shuma prej 36,000.00 euro; dhe (iii) duke marrë parasysh që kjo kërkesë nuk ishte përmbushur, më 5 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore.

22. Më 31 tetor 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [I.C.nr.238/2015], (i) e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) e detyroi BKS-në, bazuar në ekspertizën përkatëse, t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës shumën e kompensimit prej 36.000.00 euro; (iii) e detyroi BKS-në t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës kamatën prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, duke filluar nga 5 qershori 2015 deri në pagesën definitive; dhe (iv) e detyroi BKS-në të paguante shpenzimet e procedurës. Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit të saj, arsyetoi përcaktimin e kamatës ndëshkuese prej dymbëdhjetë përqind (12 %) në vit, duke u bazuar në paragrafin 6 të nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm.

23. Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit të lartcekur, kishte adresuar, ndër të tjera edhe (i) pretendimet përkitazi me parashkrimin e padisë së ngritur para saj nga BKS; dhe (ii) ato lidhur me përcaktimin e lartësisë së kamatëvonesës. Përkitazi me çështjen e parë, Aktgjykimi përkatës sqaron se bazuar në nenin 377 (Pretendimi i Dëmeve për Lëndime ose Humbje të Shkaktuara nga një Vepër Penale) të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 (në tekstin e mëtejmë: LMD e vjetër), duke marrë parasysh që dëmi është shkaktuar me vepër penale, siç është konfirmuar edhe përmes Aktgjykimit [P.nr.212/09] të 15 majit 2010 të Gjykatës së Qarkut në Prizren, përmes së cilit personi H.K. është dënuar për veprën penale rrezikim i trafikut publik të përcaktuar përmes paragrafit 5 të nenit 297 (Rrezikimi i Trafikut Publik) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, vlejnë afatet e parashkrimit të përcaktuara për veprat përkatëse penale dhe rrjedhimisht në rrethanat e rastit konkret, kërkesëpadia nuk është parashkruar. Ndërsa përkitazi me çështjen e dytë, Aktgjykimi përkatës sqaron se kamatëvonesa prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, është e përcaktuar përmes paragrafit 6 të nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm.

24. Më 13 nëntor 2017, BKS parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ose të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje. Ndërsa, më 17 nëntor 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi përgjigje në ankesë dhe propozoi që ankesa e BKS-së të refuzohet si e pabazuar. Ankesa dhe përgjigja në ankesë, ndër të tjera, argumentojnë dhe kundërargumentojë çështje që ndërlidhen me (i) parashkrimin e kërkesëpadisë; (ii) legjitimitetin aktiv të paditësit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës; dhe (iii) vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike. Përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës, parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se bazuar në nenin 382 të LMD-së, lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, ndërsa, në çështje që ndërlidhen me sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, ligj i veçantë është Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm, bazuar në nenin 26 e të cilit, lartësia e kamatëvonesës është dymbëdhjetë përqind (12%) në vit.

25. Më 31 janar 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ae.nr.289/2017], refuzoi si të pabazuar ankesën e BKS-së dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

26. Më 13 mars 2019, BKS parashtroi revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që revizioni të aprovohet si i bazuar dhe Aktgjykimet e gjykatave më të ulta të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje. Parashtruesi i kërkesës, më 2 prill 2019, parashtroi përgjigje në revizion dhe propozoi që i njëjti të refuzohet si i pabazuar.

27. Më 31 korrik 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.nr.32/2019] e (i) refuzoi si të pabazuar revizionin e BKS-së përkitazi me borxhin kryesor mbi bazën e subrogimit; ndërsa (ii) pranoi si të bazuar revizionin përkitazi me kamatëvonesën, duke e detyruar BKS-në që të paguajë kamatën prej tetë përqind (8%) nga data 5 qershor 2015 e deri në pagesën definitive. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi se (i) paragrafi 7 i nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, "*përjashton zbatimin e kamatës prej 12% për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënjën në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim*"; dhe për pasojë, (ii) paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, ka drejtë vetëm në kamatvonesën prej tetë përqind (8%) në vit, të përcaktuar përmes nenin 382 të LMD-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [E.Rev.nr.32/2019] i 31 korrikut 2019 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës, specifikisht pretendon (i) shkelje të parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës Supreme; dhe (ii) shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor përkitazi me ndryshimin e Aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit respektivisht, në lidhje me lartësinë e kamatëvonesës.

29. Përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me cenimin e sigurisë juridike, përkatësisht divergjencën në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme në lidhje me përcaktimin e kamatëvonesave në raste të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, parashtruesi i kërkesës thekson së (i) përmes ndryshimit të Aktgjykimeve të instancave më të ulëta gjyqësore, përkatësisht Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, Gjykata Supreme ka vepruar në kundërshtim më praktikën e saj gjyqësore. Në

këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës i referohet tri Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, si në vijim: (i) Aktgjykimit [E.Rev.nr.22/2019] të 1 gushtit 2019; (ii) Aktgjykimit [E.Rev.nr.27/2018] të 24 shtatorit 2018; dhe (iii) Aktgjykimit [E.Rev.23/2017] të 14 dhjetorit 2017. Në mbështetje të pretendimeve të tij për shkelje të parimit të sigurisë juridike, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të Gjykatës KI87/18, parashtrues *IF Skadeforsikring,* Aktgjykim i 26 shkurtit 2019 (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI87/18).

30. Përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës thekson se Aktgjykimi i kontestuar (i) ka ndryshuar Aktgjykimin [Ae.nr.289/2017] e 31 janarit 2019 të Gjykatës së Apelit lidhur me kamatvonesën pa mbështetje në dispozitë respektive ligjore; (ii) nuk ka arsyetuar largimin nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme lidhur me lartësinë e kamatvonesës "*në çështje identike gjyqësore*"; (iii) nuk ka sqaruar aplikimin selektiv të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, duke aplikuar të njëjtin, përkatësisht paragrafin 6 të nenit 26 të tij me rastin e përcaktimit të momentit të vonesës së debitorit, ndërsa duke aplikuar dispozitat e LMD-së në vend të nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm me rastin e përcaktimit të lartësisë së kamatvonesës, dhe se rrjedhimisht, arsyetimi përkatës është në kundërshtim me parimin "*lex specialis derogat legi generali*"; (iv) i referohet '*kamatës së thjeshtë*" dhe "*kamatës së kualifikuar*" pa asnjë bazë në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm; dhe (v) përcakton dallimin në mes të kontesteve për regresim borxhi dhe kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblim dëmi në procedurë jashtëgjyqësore, pa asnjë bazë ligjore sepse dispozitat të cilave u referohet Gjykata Supreme, përkatësisht nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm dhe paragrafit 1 të nenit 5 (Rregullimi i dëmeve) të Rregullit 3 mbi Ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia (në tekstin e mëtejmë: Rregulli 3), nuk e përcaktojnë këtë dallim.

31. Përgjatë pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës ka shtjelluar parimet themelore të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor siç është e garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe në mbështetje të këtyre argumenteve, parashtruesi i kërkesës i është referuar edhe praktikës gjyqësore (i) të Gjykatës në rastet KI55/09, parashtrues *NTSH Meteorit,* Aktgjykim i 3 dhjetorit 2010; KI135/14, parashtrues *IKK Classic,* Aktgjykim i 10 nëntorit 2015; KI97/16, parashtrues *IKK Classic,* Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017; dhe KI87/18, cituar më lart; si dhe (ii) asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë* (Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992); *Van de Hurk kundër Holandës* (Aktgjykim i 9 prillit 1994); *Hiro Balani*

kundër Spanjës (Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994); *Ruiz Torija kundër Spanjës* (Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994); *Helle kundër Holan*dës (Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997); *Souminen kundër Finlandës* (Aktgjykim i 1 korrikut 2003); dhe *Tatishvilli kundër Rusisë* (Aktgjykim i 22 shkurtit 2007).

32. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) kërkesën e tij të shpallë të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë që Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht [E.Rev.nr.32/2019] i 31 korrikut 2019 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke e shpallur të njëjtin të pavlefshëm dhe duke e kthyer çështjen në rivendosje.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SE KOSOVËS

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[....]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme"
[...]

LIGJI nr. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

Neni 382
Kamatëvonesa

1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën.
2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

LIGJI NR. 04/L-018 PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGJEGJËSIA

Neni 26
Procedura e kërkesave për dëmshpërblim

1. Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me:
1.1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse;
1.2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë
kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit.
2. Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e kompletuar me prova dhe dokumentacion të nevojshëm për të vendosur për dëmshpërblimin, siguruesi është i detyruar që, më së largu në afat prej tri (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për dëmshpërblim, të njoftojë me shkrim të dëmtuarin duke precizuar me cilat nga provat dhe dokumentacioni duhet plotësuar kërkesën. Prej ditës së pranimit, respektivisht kompletimit të dokumentacionit të kërkesës, fillojnë të zbatohen afatet nga paragrafi 1. i këtij neni për detyrimin e siguruesit përkitazi me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.
3. BQK-ja nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e procedurave për dëmshpërblim, duke përfshirë edhe përcaktimin se kur konsiderohet e kompletuar kërkesa me prova dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vendosur lidhur me dëmshpërblimin.
4. Në pamundësi të përcaktimit të dëmit, respektivisht trajtimit të dëmshpërblimit në tërësi, siguruesi përgjegjës është i detyruar t'i paguajë palës së dëmtuar pjesën jokontestuese të dëmit në formë paradhënie, brenda afatit nga paragrafi 1. i këtij neni.
5. Në rast se siguruesi përgjegjës nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në Gjykatën Kompetente.
6. Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në

lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

7. Dispozitat nga paragrafi 1., 2., 4. dhe 5. të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në rastet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim të cilat janë detyrim i byrosë për dëmet nga baza e sigurimit kufitar dhe detyrimet e Fondit të kompensimit.

8. Në kërkesat për dëmshpërblim nga sistemi i kartonit ndërkombëtar të sigurimit zbatohen procedura dhe afate të posaçme sipas Marrëveshjes së Kretës.

RREGULLI 3 MBI NDRYSHIMIN E RREGULLIT PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA AUTO-PËRGJEGJËSIA

Neni 5
Rregullimi i dëmeve

5.1 Rregullimi

Kërkesat për zhdëmtim të bazuara në sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë në pajtim me dispozitat e kësaj rregulle, përfshirë regresin nga fondi garantues duhet të zgjidhen në një periudhë kohore prej 10 ditësh prej ditës së parashtrimit të provave të nevojshme dhe dokumentacionit relevant që kërkohen nga kompania e sigurimit apo nga fondi garantues, duke iu referuar zhdëmtimit të dëmeve që kanë pasojë vdekjen, lëndime trupore apo humbjen e pasurisë.
Fondi Garantues apo një kompani e sigurimit e cila nuk e rregullon dëmin valid brenda periudhës kohore prej dhjetë (10) ditësh, duhet të paguaj dënimin e barabarte me 20% të kamatës vjetore të llogaritur nga data e raportimit të dëmit deri në datën kur zhdëmtimi është paguar apo rregulluar".

Ligjit për Gjykatat Nr. 06/L-054, i cili në nenin 14 parasheh mekanizmin për administrimin e drejtë të drejtësisë dhe shqyrtimin e ndryshimit të praktikës gjyqësore.

Neni 14
Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryetarit dhe nënkryetarit të Gjykatës

"[...]

2.10. Kryetari i gjykatës thërret takim vjetor të të gjithë gjyqtarëve për këshillim mbi Administrimin e Drejtësisë në atë gjykatë; për të

analizuar organizimin e gjykatës; për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika".

Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë miratuar nga Bordi Drejtues i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 25 shtator 2008

Neni 5
Rregullimi i dëmeve

5.1 Rregullimi

Kërkesat për zhdëmtim të bazuara në sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë në pajtim me dispozitat e kësaj rregulle, përfshirë regresin nga fondi garantues duhet të zgjidhen në një periudhë kohore prej 10 ditësh prej ditës së parashtrimit të provave të nevojshme dhe dokumentacionit relevant që kërkohen nga kompania e sigurimit apo fondit garantues, duke iu referuar zhdëmtimit të dëmeve që kanë për pasojë vdekjen, lëndime trupore apo humbjen e pasurisë.

Fondi garantues apo një kompani e sigurimit e cila nuk rregullon dëmin valid Brenda periudhës kohore prej dhjetë (10) ditësh, duhet të paguaj dënimin e barabartë me 20% të kamatës vjetore të llogaritur nga data e raportimit të dëmit deri në datën kur zhdëmtimi është paguar apo rregulluar.

Mendim Juridik për Kamatën i miratuar në mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës i 1 dhjetorit 2020, i bazuar në nenin 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat

PJESA E PARË
Ligji i aplikueshëm

I. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85,57/89).

II. Për marrëdhëniet që kanë lindur pas datës 19.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012.

PJESA E DYTË

IV. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore për të gjitha kërkesat caktohet si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar.

V. [...]

VI. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 19.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore për të gjitha kërkesat do të caktohet në lartësi prej 8 %, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.

IX. Për kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit nga të gjitha bazat e përgjegjësisë kur kreditorët kanë të drejtë në rimbursim të dëmit, lartësia e kamatës caktohet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik, varësisht se cili ligj është zbatuar (ka qenë në fuqi) kur kreditori në cilësinë e debitorit ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë.

Situatat kur aplikohet norma e interesit vjetor prej 12 %:

- *Kur kërkesat e paraqitura tek Kompanitë e Sigurimeve, për dëmin në persona, nuk trajtohen në afat prej 60 ditësh;*

- *Kur kërkesat e paraqitura tek Kompanitë e Sigurimeve, për dëmin në pasuri, nuk trajtohet brenda 15 ditësh;*

Arsyetimi i Mendimit Juridik

Arsyetimi për pikën IX (nëntë) të mendimit juridik- *Në praktikën gjyqësore paraqiten raste të shpeshta të kreditorëve për rimbursim të dëmit të cilët kanë përmbushur detyrimet paraprakisht ndaj palëve të treta, e të cilat kryesisht ndërlidhen me rastet e siguruara nga kompanitë e sigurimeve vendore me kompanitë e huaja. Për këtë lloj të kërkesave në praktikën e gjykatave është vërejtur interpretim dhe zbatim i dispozitave ligjore në disa forma sa i përket shkallës/lartësisë së kamatëvonesës për rastet e kërkesave për rimbursim. Kjo ka ndodhur për shkak se kreditorët me rastin e paraqitjes së kërkesave për rimbursim të dëmit duke iu referuar nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, kanë kërkuar që rimbursimi i kërkesës të bëhet me normë vjetore prej 12%, mirëpo*

Gjykata Supreme e Kosovës në Seancën e Përgjithshme të saj përmes këtij mendimi juridik ka vlerësuar se nuk mund të aplikohet norma/kamatëvonesa vjetore prej 12% në të gjitha rastet. Kjo për shkak se kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit kryesisht u referohen situatave për marrëdhëniet juridiko-civile (jokontraktuale për kreditorin dhe debitorin), prandaj, në një rast të tillë sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kamatëvonesa vjetore duhet të paguhet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik. Kjo nënkupton se në rast se kreditori ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë, para datës 20.12.2012, norma e interesit do të zbatohet si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, ndërsa në rast se kreditori ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë pas datës 19.12.2012, atëherë shkalla/lartësia e kamatëvonesës do të zbatohet në shkallë prej 8%.

Përveç të cekurave Gjykata Supreme vlerëson se shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore prej 12%, nuk mund të zbatohet edhe për shkak të faktit se sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare me nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, interesi vjetor 12%, vjen në shprehje për shkak të neglizhencës së kompanive të sigurimeve (të cilat pastaj paraqiten si kreditor regresues), sepse sikur kreditorët regresues t'i kishin trajtuar konform përgjegjësive ligjore kërkesat e palëve të treta, ndaj tyre nuk do të mund të zbatohej shkalla/lartësia e kamatëvonesës prej 12%, në vendimet e gjykatës, por do të zbatohej shkalla/lartësia si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, apo shkalla/lartësia prej 8%, varësisht se cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e lindjes së marrëdhënies së detyrimit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

35. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

36. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".

37. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për

individët dhe personat juridikë (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI118/18, parashtrues *Eco Construction sh.p.k.,* Aktvendim për papranueshmëri i 10 tetorit 2020, paragrafi 29). Ndërsa, për sa i përket përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj e të referuara më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [E.Rev.nr.32/2019] e 31 korrikut 2019 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

38. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

39. Gjykata gjithashtu vëren që kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër.

40. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Meritat

41. Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me një aksident të vitit 2009, në të cilin, e siguruara e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht Sh.Z., kishte humbur jetën. Përgjegjësia për aksident kishte rënë mbi H.K.-në, i siguruar i BKS-së, i cili ishte dënuar për veprën penale rrezikim i trafikut publik në vitin 2010. Parashtruesi i kërkesës e kishte kompensuar familjen e të ndjerës në shumën prej 36,000.00 euro. Përkitazi me këtë shumë në vitin 2015, parashtruesi i kërkesës iu drejtua BKS-së me kërkesë për kompensim mbi bazën e të drejtës në subrogim të përcaktuar përmes LMD-së, dhe në mungesë të një marrëveshjeje, iu drejtua Gjykatës Themelore përmes padisë. Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, i kishin dhënë të drejtë parashtruesit të kërkesës, duke konfirmuar detyrimin e BKS-së që të kompensojë parashtruesin e kërkesës në vlerën e lartcekur dhe gjithashtu detyrimin për të paguar kamatën prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, duke filluar nga 5 qershori 2015 deri në pagesën definitive.

Gjykata Supreme gjithashtu përfundimisht kishte konfirmuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës në kompensimin përkatës mbi bazën e subrogimit, por kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore edhe asaj të Apelit, përkitazi me kamatëvonesën. Gjykata Supreme, kishte përcaktuar që kamata vjetore duhet të jetë tetë përqind (8%) në vit, bazuar në nenin 382 të LMD-së dhe jo dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, siç kishin vendosur gjykata e shkallës më të ulët. Këtë konstatim të Gjykatës Supreme, përkitazi me lartësinë e kamatvonesës, parashtruesi i kërkesës e konteston para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KENDJ-së, për shkak të (i) cenimit të parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës Supreme; dhe (ii) mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor.

42. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, përpos që pretendon shkelje të parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës në praktikën përkatëse gjyqësore, ai gjithashtu pretendon mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, duke theksuar, ndër tjerash dhe siç është sqaruar më lart, se Aktgjykimi i kontestuar (i) ka ndryshuar Aktgjykimin [Ae.nr.289/2017] e 31 janarit 2019 të Gjykatës së Apelit lidhur me kamatëvonesën pa mbështetje në dispozitën respektive ligjore; (ii) nuk ka arsyetuar largimin nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme lidhur me lartësinë e kamatvonesës "në çështje identike gjyqësore"; (iii) nuk ka sqaruar aplikimin selektiv të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, duke aplikuar të njëjtin, përkatësisht paragrafin 6 të nenit 26 të tij me rastin e përcaktimit të momentit të vonesës së debitorit, ndërsa duke aplikuar dispozitat e LMD-së në vend të nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm me rastin e përcaktimit të lartësisë së kamatvonesës, dhe se rrjedhimisht, arsyetimi përkatës është në kundërshtim me parimin "*lex specialis derogat legi generali*"; (iv) i referohet "*kamatës së thjeshtë*" dhe *"kamatës së kualifikuar*" pa asnjë bazë në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm; dhe (v) përcakton dallimin në mes të kontesteve për regresim borxhi dhe kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblim dëmi në procedurë jashtëgjyqësore, pa asnjë bazë ligjore sepse dispozitat të cilave u referohet Gjykata Supreme, përkatësisht nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm dhe paragrafit 1 të nenit 5 të Rregullit 3, nuk e përcaktojnë këtë dallim.

43. Këtë kategori pretendimesh, e që ndërlidhen me mungesën e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë

themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, dhe në vijim, në mënyrë që të konstatojë nëse Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është në përputhshmëri me garancitë e përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje ne nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me vendimin e arsyetuar gjyqësor, Gjykata fillimisht do të rikujtojë parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës duke filluar me ato që ndërlidhen me cenimin e sigurisë juridike, dhe më pas do të aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

Përkitazi me cenimin e sigurisë juridike

(i) Parimet e përgjithshme siç janë zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës

44. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon mungesë të konsistencës, përkatësisht divergjencë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme në lidhje me përcaktimin e kamatëvonesave në raste të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, duke iu referuar tri Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, si në vijim: (i) Aktgjykimit [E.Rev.nr.22/2019] të 1 gushtit 2019; (ii) Aktgjykimit [E.Rev.nr.27/2018] të 24 shtatorit 2018; dhe (iii) Aktgjykimit [E.Rev.23/2017] të 14 dhjetorit 2017.

45. Përkitazi me parimin e sigurisë juridike si rezultat i mungesës së konsistencës në praktikën gjyqësore, GJEDNJ në praktikën e saj ka zhvilluar parime themelore dhe vendosur kriteret nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Kriteret e vendosura nga GJEDNJ, Gjykata gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse i ka zbatuar edhe në praktikën e saj gjyqësore (shih, ndër të tjera, rastet e lartcekura të Gjykatës KI35/18 dhe KI87/18, ku Gjykata konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së).

46. Në vijim të kësaj, Gjykata vë në pah se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka rezultuar në katër parime themelore që e karakterizojnë analizën lidhur me konsistencën e praktikës gjyqësore, si vijon: (i) se një nga komponentët thelbësorë të sundimit të ligjit është siguria juridike, e cila, ndër të tjera, garanton një siguri të caktuar në situata juridike dhe kontribuon në besim publik në gjykata (shih, mutatis mutandis, *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 38155/02, Aktgjykim i 2 nëntorit 2010, paragrafi 38, *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 56, shih

rastin KI35/18, të cituar më lart, paragrafi 64); (ii) se nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore (shih rastin e GJEDNJ-së, të cituar më lart, *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, paragrafi 56, shih po ashtu rastin e cituar më lartë të Gjykatës KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverbrand*, paragrafi 65, si dhe rastin KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 janarit 2018, paragrafi 33); (iii) se mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor i bazuar mbi rrjetin e gjykatave themelore dhe të apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial, dhe një shmangie mund të ndodhë edhe brenda të njëjtës gjykatë, e cila shmangie, në vetvete nuk mund të konsiderohet e kundërt në vetvete (shih rastin *Santos Pinto kundër Portugalisë*, kërkesa nr. 390005/04, paragrafi 41, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41, shih po ashtu rastin e Gjykatës KI87/17, parashtrues *"IF Skadeforsikring"*, të cituar më lartë, paragrafi 66 dhe rastin KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverbrand*, paragrafi 67); dhe (iv) përveç rasteve të arbitraritetit të dukshëm, nuk është detyrë e saj të vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendas nga ana e gjykatave vendore dhe në parim, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme (shih, për shembull, rastet e GJEDNJ-së *Ādamsons kundër Letonisë*, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118; dhe *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 50; dhe rastin KI35/18, të cituar më lart, paragrafi 68).

47. Megjithatë, GJEDNJ duke iu referuar parimeve të lartcekura ka vendosur tre kritere themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, si në vijim: (i) nëse ekzistojnë dallime të thella dhe afatgjata" në praktikën gjyqësore; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, *Beian kundër Rumanisë* (nr.1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 29 nentorit 2016, paragrafët 116 - 135; *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe shih rastin e Gjykatës, Kl29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shtatorit 2017, paragrafi 51 dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës të cituar më lartë, KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, paragrafi 39, KI87/17 parashtrues "*IF Skadiforsikring"*, paragrafi 67, KI35/18 parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 70).

(ii) Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

48. Në vijim, Gjykata do të aplikojë parimet e shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret, duke aplikuar kriteret mbi bazën e të cilave GJEDNJ trajton çështjet e divergjencës përkitazi me praktikën gjyqësore, duke filluar me vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, (i) kundërthëniet e pretenduara në praktikën gjyqësore janë "të thella dhe afatgjata"; dhe nëse ky është rasti, (ii) ekzistimin e mekanizmave të aftë për të zgjidhur divergjencën përkatëse; dhe (iii) vlerësimin nëse këta mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti në rrethanat e rastit konkret.

49. Në këtë kontekst, Gjykata duhet gjithashtu të ritheksojë se, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër që në raste të tilla, përkatësisht pretendimeve për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikën gjyqësore, parashtruesit e kërkesave duhet të i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar kështu në divergjencë në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin KI35/18, parashtrues *"Bayerische Rechtsverband"*, të cituar më lart, paragrafi 76).

50. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon së në rastin e tij, Gjykata Supreme ka vendosur ndryshe përkitazi më lartësinë e kamatëvonesës, duke vepruar në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore. Në mbështetje të argumenteve të tij, parashtruesi i kërkesës i referohet tri Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, si në vijim: (i) Aktgjykimit [E.Rev.nr.22/2019] të 1 gushtit 2019; (ii) Aktgjykimit [E.Rev.nr.27/2018] të 24 shtatorit 2018; dhe (iii) Aktgjykimit [E.Rev.23/2017] të 14 dhjetorit 2017.

51. Para analizës nëse (i) Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktgjykimi [E. Rev. nr.32/2019] i 31 korrikut 2019 është nxjerrë nga Gjykata Supreme në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore; dhe (ii) divergjencat e pretenduara në praktikën gjyqësore janë "të thella dhe afatgjata", Gjykata fillimisht rikujton arsyetimin e Aktgjykimit të kontestuar përkitazi me kamatëvonesën. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme në rrethanat e rastit konkret, pranoi si të bazuar revizionin përkitazi me kamatëvonesën, duke e detyruar BKS-

në që të paguajë kamatën prej tetë përqind (8%) nga data 5 qershor 2015 e deri në pagesën definitive. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi se (i) kamatëvonesa në lartësi prej 12 % është paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënjën në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim"; dhe për pasojë, (ii) paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, ka drejtë vetëm në kamatëvonesën prej tetë përqind (8%) në vit, të përcaktuar përmes nenin 382 të LMD-së.

52. Në këtë kontekst, dhe përkitazi me ligjet e aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 maj 2012, është Dekretuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës më 30 maj 2012, është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 19 qershor 2012, dhe bazuar në nenin 1059 të tij (Hyrja në fuqi), ka hyrë në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, rrjedhimisht më 19 dhjetor 2012, ndërsa Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 23 qershor 2011, është Dekretuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës më 5 korrik 2011, është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 14 korrik 2011, dhe bazuar në nenin 44 të tij (Hyrja në fuqi), ka hyrë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare, rrjedhimisht më 29 korrik 2011. Për më tepër, ky ligj, përmes nenit 43 të tij, ka përcaktuar shfuqizimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/25 që rregullon sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë si dhe aktet respektive nënligjore të Bankës Qendrore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: BQK), e të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj.

53. Në vijim, Gjykata do të riprodhojë pjesët relevante të disa prej vendimeve të lartpërmendura, ku parashtruesi i kërkesës iu referohet në mbështetje të pretendimeve të tij.

54. Në rastin e parë, përkatësisht Aktgjykimi [E. Rev. 22/2019] të 1 gushtit 2019 rrethanat e këtij rasti ndërlidheshin me një aksident që kishte ndodhur më 1 gusht 2011, në të cilin aksident i siguruari Sh. Sh. i Kompanisë "Suva Rechtsabteilung" kishte pësuar lëndime. Kërkesëpadia për kompensim të dëmit sipas të drejtës së subrogimit, e parashtruar nga Kompania "Suva Rechtsabteilung" ishte miratuar si e bazuar dhe ishte përcaktuar kamatëvonesa sipas Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm. Si rezultat i revizionit të parashtruar nga Kompania e Sigurimeve "Insing", Gjykata Supreme përcaktoi se "*gjykatat e shkallës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitën nenit 26 pika 6 të Ligjit për Sigurimin e Detyruar nga Auto përgjegjësia (Ligji nr. 04/4-018), i cili ka hyrë në fuqi më 5 korrik 2011 ngase paditësi me datën 27.4. 2012 ka iniciuar kërkesë për regresim borxhi në procedurë*

jashtëgjyqësore, çka rezulton se nga kjo datë e paditura ka rënë në vonesë në kuptim të nenit 305 LMD të Republikës së Kosovës, andaj paditësi ka të drejtë në kamatë ndëshkuese të paraparë me nenin 26 të ligjit të lartpërmendur, nga të cilat kjo Gjykatë pretendimin e të padituës se gjykata e instancës më të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar të drejtën materiale me rastin e caktimit të kamatës, e vlerësoi si të pabazuar."

55. Në rastin e dytë, përkatësisht Aktgjykimit [E.Rev.nr.27/2018] të 24 shtatorit 2018, rrethanat e rastit ndërlidhen me një aksident të ndodhur më 31 dhjetor 2010, në të cilin rast si rezultat i kërkesëpadisë së Kompanisë "Suva Rechtasabteilung" Gjykata Themelore kishte pranuar në tërësi kërkesëpadinë e saj duke caktuar kamata ndëshkuese me 20 % duke filluar nga 15 prilli 2011 deri më 29 korrik 2011, ndërsa kamatën vjetore prej 12% nga data 29 korriku 2011 deri në pagesën definitive. Gjykata e Apelit pjesërisht kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore vetëm sa i përket lartësisë së kamatëvonesës "*mbi shumën e aprovuar nga 88,000 euro parashtruesit ti paguajnë kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjete e deponuara në bakë mbi një vit pa destinim të caktuar me një dënim shtesë në shumë prej 20% të normës së kamatës vjetore duke filluar nga dt. 15.04.2011 si ditë e raportimit të dëmit deri më datën 29.07.2011, ndërsa nga data 30.07.2011 e deri në pagesën definitive, kamatën në shumën 88,000 euro do të llogaritet sipas normës vjetore 12%."* Në fund, si rezultat i revizionit të parashtruar nga Kompania e Sigurimeve "Illyria", Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj, [E.Rev.nr.27/2018] të 24 shtatorit 2018 pranoi revizionin e të padituës vetëm sa i përket kamatëvonesës, duke e ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në këtë pjesë dhe duke e vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

56. Ndërsa, në rastin, përkatësisht Aktgjykimin [E. Rev. 23/2017] e 14 dhjetorit 2017 të Gjykatës Supreme rrethanat e këtij rasti ndërlidhen me një aksident të ndodhur 28 shtator 2009, në të cilin rast si rezultat i kërkesëpadisë së Kompanisë së Sigurimeve IF "Insurance" në Norvegji, Gjykata Themelore kishte vendosur kamatën ndëshkuese në lartësi prej 20 % [sipas nenit 5.1 të Rregullit 3 të Bankës Qendrore mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisës] duke filluar nga 15 prilli 2011 deri më 29 korrik 2011, ndërsa kamatën vjetore prej 12% nga data 29 korriku 2011 deri në pagesën definitive. Gjykata e Apelit pjesërisht kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore vetëm sa i përket lartësisë së kamatëvonesës "*mbi shumën e aprovuar nga 24,030.00 euro parashtruesit ti paguajnë kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjete e deponuara në bakë mbi një vit pa destinim të caktuar*

me një dënim shtesë në shumë prej 20% të normës së kamatës vjetore duke filluar nga dt. 22.04.2010 si ditë e raportimit të dëmit deri më datën 29.07.2011, ndërsa nga data 30.07.2011 e deri në pagesën definitive, kamata mbi shumën e gjykuar do të llogaritet sipas normës vjetore 12%."Si rezultat i revizionit të parashtruar nga Kompania e Sigurimeve, Gjykatë Supreme revizionin e saj pjesërisht e kishte aprovuar dhe kishte vendosur se"[. ..] sa i përket lartësisë se kamatës, ndryshohet aktgjykimi i goditur i Gjykatës se Apelit te Kosovës Ae. nr. 53/2016 te datës 21.09.2017 dhe detyrohet e paditura që në shumën e aprovuar të kërkesëpadisë t'ia paguaj paditësit kamatën ne lartësi prej 20% duke filluar nga data 22.04.2010 si ditë e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të dëmit e deri me 29.07.2011, ndërsa nga data 30.07.2011 e deri në pagesën definitive kamatës në lartësi prej 12% në shumën e gjykuar".

57. Në kontekst të Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të referuara nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se në të tri (3) rastet nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm ishte aplikuar kamatëvonesa prej 12% bazuar në nenin 26, paragrafin 6 të këtij ligji, gjegjësisht ishte përcaktuar edhe momenti prej të cilës kjo kamatëvonesë fillon të llogaritet. Në rastet [E. Rev. 23/2017] të 14 dhjetorit 2017 dhe [E.Rev.nr.27/2018] të 24 shtatorit 2018, ishte caktuar 30 korriku 2011, si datë kur kamatëvonesa do të zbritej prej 20% në 12%, duke aplikuar kështu nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm.

58. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, i kishin dhënë të drejtë parashtruesit të kërkesës, duke konfirmuar detyrimin e BKS-së që të kompensojë parashtruesin e kërkesës në vlerën e lartcekur dhe gjithashtu detyrimin për të paguar kamatën prej dymbëdhjetë përqind (12%) në vit, duke filluar nga 5 qershori 2015 deri në pagesën definitive, duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm.

59. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme në prishjen e Aktgjykimeve të gjykatave më të ulëta, përkitazi me kamatëvonesën, kishte përjashtuar aplikimin e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm duke konstatuar se kamatëvonesa në lartësi prej 12 % është paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënjën në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim"; dhe për pasojë, (ii) paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, ka drejtë vetëm në kamatëvonesën prej tetë përqind (8%) në vit, të përcaktuar përmes nenin 382 të LMD-së.

60. Gjykata thekson se ajo vlerëson konsistencën e praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta vetëm në raport me shkeljet e pretenduara të

parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, mungesa e konsistencës në praktikën gjyqësore duhet të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës. Për të konstatuar një shkelje të tillë, dhe për të konstatuar se të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës janë shkelur si rezultat i "dallimeve të thella dhe të afatgjata" në praktikën përkatëse gjyqësore, rrethanat faktike dhe juridike të rastit të parashtruesit të kërkesës duhet të përkojnë më ato të rasteve kundërthënia me të cilat pretendohet.

61. Në kontekst të rrethanave të rastit, Gjykata dhe GJENDJ gjithashtu kanë pranuar se kundërthëniet në praktikën gjyqësore janë pjesë përbërëse e secilit sistem gjyqësor dhe se divergjenca në praktikën gjyqësore mund të ketë edhe brenda të së njëjtës gjykatë. Një gjë e tillë, nuk është detyrimisht në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih rastet e GJEDNJ-së, *Santo Pinto kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 41; dhe *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 51). Për më tepër, dhe siç është cekur më lart, GJEDNJ ka theksuar vazhdimisht se kërkesat për siguri juridike dhe mbrojtje legjitime të besimit të publikut në gjykata nuk garantojnë një të drejtë në praktikën gjyqësore konsistente. Zhvillimi i praktikës gjyqësore është i rëndësishëm për të mbajtur dinamikën e duhur të përmirësimit të vazhdueshëm të administrimit të drejtësisë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Atanasovski kundër "Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë"*, Aktgjykim i 14 janarit 2010, paragrafi 38; dhe *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 58, shih rastin e Gjykatës KI35/18, me parashtrues *Bayerische Rechtsverband*, të cituar më lart, paragrafi 98). Përjashtim nga këto parime të përgjithshme, është arbitrariteti i dukshëm, dhe në kuptim të vlerësimit të mungesës së konsistencës gjyqësore, vlerësimi nëse ka "dallime të thella dhe afatgjata" në praktikën përkatëse gjyqësore dhe nëse ka një mekanizëm efektiv për të adresuar të njëjtat.

62. Gjykata, duke ju referuar praktikës së vet gjyqësore, përkatësisht rasteve KI87/18 dhe KI35/18, rikujton se kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të shkeljes së parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës së praktikës gjyqësore, në rastin KI87/18 në vlerësimin e 3 (tre) rasteve të Gjykatës Supreme, të nxjerra në një periudhë kohore 3 (tre) vjeçare, dhe në rastin KI35/18 në vlerësimin e 9 (nëntë) rasteve të Gjykatës Supreme të nxjerra në një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare dhe pasi kishte konstatuar se (i) kishte "dallime të thella dhe afatgjata"; (ii) mekanizmi i Gjykatës Supreme për harmonizimin e praktikës gjyqësore ekzistonte; por se (iii) mekanizmi i lartpërmendur nuk ishte përdorur (shih rastin e Gjykatës KI87/18, cituar më lart, paragrafi 79 dhe

paragrafët 81 deri 85, dhe rastin KI35/18, cituar më lart, paragrafi 70 dhe paragrafët 110-111).

63. Në anën tjetër, vetëm konstatimi se ka *"dallime të thella dhe afatgjata"* në praktikën gjyqësore përkitazi me lartësinë e kamatëvonesave, nuk rezulton detyrimisht në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Për të konstatuar një gjë të tillë, Gjykata duhet të shqyrtojë edhe dy kriteret e tjera të GJEDNJ-së që ndërlidhen me vlerësimin e mungesës së konsistencës në praktikën gjyqësore, përkatësisht nëse ligji i aplikueshëm përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe nëse një mekanizëm i tillë është zbatuar në rrethanat e një rasti dhe me çfarë efekti.

64. Gjykata thekson se Gjykata Supreme ka një mekanizëm që mundëson zgjidhjen e kundërthënieve të tilla, bazuar në pikën 10 të paragrafit 2 të nenit 14 (Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryetarit dhe nënkryetarit të Gjykatës) të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Gjykatat). Kryetarët e gjykatave përmes takimeve vjetore të të gjithë gjyqtarëve kanë detyrimin, ndër të tjera, për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika (shih rastin e Gjykatës KI87/18 parashtrues *"IF Skadeforsikring"*, cituar më lart, paragrafi 80 dhe rastin KI35/18, parashtrues *Bayerische Rechtsverband*, të cituar më lart, paragrafi 107).

65. Në vijim, dhe me qëllim të qartësimit nëse një mekanizëm i tillë për zgjidhjen e kundërthënieve, të cilat në vazhdimësi ishin pretenduar nga parashtruesit e kërkesave në raste të tilla para Gjykatës, Gjykata rikujton se në kërkesën e saj, të 22 tetorit 2020, i ishte drejtuar Gjykatës Supreme edhe me pyetjen nëse: "*Gjykata Supreme kishte nxjerrë ndonjë qëndrim parimor në lidhje me kompensimin e dëmit dhe caktimit të kamatëvonesës përkitazi me kërkesat në kuadër të së drejtës në subrogim*".

66. Gjykata Supreme në përgjigjen e saj ndaj pyetjes së lartcekur ishte përgjigjur si në vijim:

"Praktikën gjyqësore të përshkruar më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës e ka të konsoliduar prej kur janë paraqitur kërkesat për kompensim të dëmit sipas të drejtës së subrogimit, por duhet dalluar rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës në procedurën sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike nuk mundet të ndryshoje vendimet e instancave më të ulëta ne raste kur do të konsiderohej cenim i parimit "reformatio in peius".

Me dispozitën e nenit 203 te Ligjit për Procedurën Kontestimore është përcaktuar se: " Gjykata e shkalles së dytë nuk mund ta ndryshoje aktgjykimin e shkalles së parë në dëm të palës ankuese, po qe se vetëm ajo ka bërë ankim, e jo edhe pala kundërshtare".

Parimi i cituar e pengon Gjykatën Supreme të ndryshojë vendimet e instancave më të ulëta edhe sa i përket normës vjetore të kamatëvonesës nëse revizioni është i palës paditëse, e cila pjesërisht e ka fituar kontestin gjyqësor, por ka paraqit revizion për pjesën e refuzuar. Në këtë rast Gjykata Supreme edhe nëse e konstaton se gabimisht janë zbatuar dispozitat material juridike për kamatëvonesën nuk mund të ndryshoje vendimin gjyqësor. Po ashtu, Gjykata Supreme, kur revizioni është paraqitur vetëm përkitazi me kamatën nuk mund të lëshohet fare në vlerësimin e bazueshmëriseë së tij dhe eventualisht të ndryshojë aktgjykimet e instancës më të ultë, sepse në këtë situatë revizioni fare nuk është i lejuar në pajtim me nenin 211 paragrafi 2, i LPK-se, pasi që në kuptim të nenit 30 paragrafi 1, të LPK-se, për vlerat e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore, e jo edhe kamata (neni 30 paragraf2 te LPK-së).

Gjykata Supreme e Kosovës në refleksion të kërkesave të vazhdueshme të gjykatave të instancave më të ulëta, por edhe nga të gjeturat në praktiken e saj gjyqësore para disa muajsh ne degën civile është iniciuar ideja për nevojën e një mendimi juridik për çështjen e kamatës, për te cilën ide janë bërë hulumtime në praktikën e brendshme, janë bërë analiza krahasimore për legjislacionin dhe praktiken në regjion, është vlerësuar nevoja e ruajtjes se kontinuitetit, por edhe nevoja për ndryshime progresive në funksion të përmbushjes së standardeve për mbrojte adekuate gjyqësore dhe pas mbajtjes së shumë takimeve, kjo ide është materializuar ne mendim juridik, fillimisht në degën civile të Gjykatës Supreme dhe pastaj në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të mbajtur me datë 01 dhjetor 2020.

Mendimi juridik për çështjen e kamatës ka adresuar përveç të tjerave edhe situatën e regresit të kërkesave, pika IX (nëntë) e mendimit juridik. Pjesë të kësaj përgjigje për informatat e kërkuara ju lutem ta konsideroni edhe Mendimin juridik për kamatën, një kopje të se cilit e gjeni të bashkangjitur."

67. Megjithatë, Gjykata përmes rastit të tanishëm gjithashtu thekson se pika 4 e paragrafit 1 të nenit 26 (Kompetencat e Gjykatës Supreme) të Ligjit për Gjykatat, përcakton kompetencën ekskluzive të vet Gjykatës Supreme për të përcaktuar qëndrimet parimore, nxjerrë mendime

juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Republikës së Kosovës. Në çështjen që ngërthejnë rrethanat e rastit konkret, përkatësisht aplikimin e lartësisë së kamatëvonesës përkitazi më sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, Gjykata Supreme, një mekanizëm të tillë, përkatësisht një mendim juridik përkitazi me kamatën e kishte aprovuar më 1 dhjetor 2020, gjegjësisht pasi që parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë dhe pas kërkesës së Gjykatës, përmes të cilës ishte kërkuar që të sqarohej nëse Gjykata Supreme ka nxjerrë ndonjë qëndrim unifikues përkitazi me praktikën e saj gjyqësore.

68. Rrjedhimisht, Gjykata, marrë parasysh elaborimin e tri rasteve të lartcekur të Gjykatës Supreme dhe përgjigjes së Gjykatës Supreme, përmes shkresës së saj të 2 dhjetorit 2020, konstaton se në rrethanat e rastit konkret, nuk plotësohen të tri kriteret e GJEDNJ-së përkitazi me vlerësimin nëse mungesa e konsistencës, përkatësisht divergjencat në praktikën gjyqësore, kanë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

69. Gjykata, së pari rithekson se në rrethanat e rastit konkret nuk ka konstatuar *"dallime të thella dhe afatgjata"* në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme përkitazi me aplikimin e dispozitave që rregullojnë lartësinë e kamatëvonesës në kontekst të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia më dorëzimin e vetëm tri (3) vendimeve. Së dyti, Gjykata konsideron se sqarimi i dhënë i Gjykatës Supreme përmes shkresës së saj në lidhje me zbatimin e dispozitave të ligjit në rastet e kërkesave që i referohen caktimit të lartësisë së kamatëvonesës në kuadër të së drejtës në subrogim është i qartë. Përderisa sa i përket mekanizimit të Gjykatës Supreme për harmonizimin e kësaj praktike, respektivisht aprovimi i Mendimit ligjor përkitazi me Kamatën, Gjykata thekson se ky mekanizëm është krijuar dhe është aprovuar pas parashtrimit të një numër rasteve në Gjykatë e të cilat kontestojnë Aktgjykimet e Gjykatës Supreme për sa i përket përcaktimit të kamatëvonesës në rastet e kërkesave për kompensim të dëmit në bazë të së drejtës për subrogim.

70. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Aktgjykim i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk është i përfshirë në cenim të parimit të sigurisë juridike dhe në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të parashtruesit të kërkesës, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përkitazi me vendimin e arsyetuar gjyqësor

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore

71. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 199 8; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës,* Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, me parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, me parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, me parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu,* Aktgjykim i 27 majit 2019; KI35/18, cituar më lart; dhe KI227/19, me parashtrues *N.T. "Spahia Petrol",* Aktgjykim i 31 dhjetorit 2020.

72. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139).

73. Gjykata, po ashtu thekson se, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, e cila mbështetet në praktikën gjyqësorë të GJEDNJ-së, gjatë vlerësimit të parimit, i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih, në mënyrë të ngjashme, rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart,

paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Morerira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

74. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih rastet e Gjykatës KI 87/18 parashtrues *"IF Skadeforsikring"*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; KI138/19, parashtrues *Ibish Raci*, cituar më lart, paragrafi 45; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138).

(ii) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

75. Në aplikimin e parimeve të përgjithshme e të shtjelluara më lart, në rrethanat e rastit konkret, dhe në mënyrë që të vlerësohet nëse Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në përputhje me garancitë kushtetuese për një vendim të arsyetuar gjyqësor, Gjykata rikujton që në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar të saj, Gjykata Supreme kishte ndryshuar Aktgjykimet e gjykatave më të ulëta, përkitazi me kamatëvonesën. Këto të fundit, në rrethanat e rastit konkret, kishin aplikuar kamatën në lartësinë prej dymbëdhjetë përqind (12) % në vit, duke u referuar në nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm, ndërsa Gjykata Supreme kishte përcaktuar se në rrethanat e rastit përkatës, nuk është i aplikueshëm nenin 26 i Ligjit për Sigurimin nga Autopërgjegjësia, por duhet të aplikohet kamata në lartësinë prej tetë përqind (8) %, duke u referuar në nenin 382 të LMD-së.

76. Në kontekst të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet pjesës relevante të Aktgjykimit [E.Rev.Nr. 32/2019] të Gjykatës Supreme, ku përkitazi me kamatëvonesën, theksohet si në vijim:

"Mirëpo, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë lidhur me pjesën që ka të bëjë me kamatën e gjykuar përfshihet me zbatimin e gabuar të se drejtës materiale nga neni 382 LMD-së (nr 04/L-077), dhe lidhje me nenin 26.7 të Ligjit për sigurinë e detyrueshëm nga auto përgjegjësia nr (04/L-018 e cila ka hyre në fuqi me 30 korrik 2011).

Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale qëndron në faktet se, si është thënë më lart, kërkesëpadia e paditësit për shpërblim të dëmit si dhe padia është paraqitur në kohën kur ka hyrë në fuqi Ligji për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Kamata e aprovuar nga gjykatat e instancës me të ulët, ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për regresim të borxhit por vetëm në kërkesat e trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblim të dëmit në procedurën jashtëgjyqësore ashtu siç parashihet në nenin 26 të Ligjit në fjalë dhe nenit 5.1 të Rregullit të BQK-së nr. 3 mbi ndryshimin e Rregullit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia të datës 25 shtator 2008, në të cilat dispozita thirren gjykatat e instancës së ulët. Ato kamata të cilat i kanë aplikuar gjykata e shkallës së parë dhe të dytë janë të parapara me qëllim të disiplinimit të kompanive siguruese në raportet e sigurimit ndaj kërkesave për dëmshpërblim të personave të dëmtuar të cilat kërkesa kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që t'i trajtojnë me urgjencë brena afateve të parapara sipas dispozitave të lartpërmendura.

Par. 7 nenit 26 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, përjashton zbatimin e kamatës prej 12% për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rrënjën në vonese të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim. Nga kjo rezulton se paditësi ka drejtë vetëm në kamatëvonese të paraparë me nenin 382 LMD jo edhe kamatë 'të kualifikuar" sipas dispozitave të zbatuara nga gjykatat e shkallës së parë dhe asaj të dytë."

77. Gjykata vëren se Gjykata Supreme në aktgjykimin e kontestuar ka përcaktuar: (i) se dispozitat ligjore relevante për rastin e parashtruesit të kërkesës janë neni 382 i LMD-së në lidhje me nenin 26.7 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm; (ii) se kamata prej 12 % nuk zbatohet në rastet për regresim të borxhit por vetëm në kërkesat e trajtimit të personave të dëmtuar për shpërblim të dëmit në procedurë jashtëgjyqësore; (iii) se kamata prej 12% zbatohet vetëm për mos trajtim dhe rënie në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim dhe jo për regresim borxhi; dhe, se (iv) për këto arsye, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në kamatëvonesë të

paraparë me nenin 382 të LMD-së (8%) dhe jo kamatë të "kualifikuar" (12%).

78. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet nenit 382, paragrafit 2 të LMD-së, i cili përcakton që: "*Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*".

79. Ndërsa paragrafi 6 i nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm përcakton që: "*Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim*".

80. Duke u bazuar në atë si më lart, Gjykata vëren se në përcaktimin e kamatëvonesës "në lartësi prej 8%" sipas paragrafit 2 të nenit 382 të LMD-së Gjykata Supreme specifikoi se përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës në rastet e kërkesave sipas së drejtës në subrogim, në të cilat raste hyn edhe rasti i parashtruesit të kërkesës, paragrafi 6 i nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nuk është i aplikueshëm.

81. Për më tepër, Gjykata vëren se si arsye për ndryshimin e vendimit në lidhje me lartësinë e kamatëvonesës, Gjykata Supreme arsyeton se gjykatat e shkallës më të ulët, respektivisht Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit gabimisht kanë interpretuar të drejtën materiale kur kanë konstatuar se paragrafi 6 i nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm është i aplikueshëm.

82. Gjykata në kontekst të pretendimeve të ngjashme që ndërlidhen me lartësinë e kamatëvonesës, më 22 tetor dhe 24 nëntor 2020, respektivisht, i dërgoi një shkresë Gjykatës Supreme, përkitazi me një numër rastesh të dorëzuara në Gjykatë e të cilat kontestojnë Aktgjykime të Gjykatës Supreme për sa i përket përcaktimit të kamatëvonesës në rastet e kërkesave për kompensim të dëmit në bazë të së drejtës për subrogim si rezultat i aksidenteve të trafikut të shkaktuara në Republikën e Kosovës. Gjykata kërkoi sqarim nëse (i) Gjykata Supreme ka nxjerrë një qëndrimi parimor në lidhje me kompensimin e dëmit dhe caktimit të kamatëvonesës përkitazi me kërkesat në kuadër të së drejtës në subrogim; dhe nëse ky nuk është rasti (ii) të njoftohet Gjykata përkitazi me praktikën e Gjykatës Supreme, se në cilat raste zbatohet neni 382 (Kamatëvonesa) i Ligjit

Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet Detyrimore dhe në cilat raste zbatohet paragrafi 6 i nenit 26 (Procedura e kërkesave për dëmshpërblim) të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

83. Në pyetjen e lartcekur të Gjykatës, Gjykata Supreme ishte përgjigjur si në vijim:

"Në këtë kontekst, në mënyrë parimore lidhur me kamatëvonesën për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, është zbatuar dispozita ligjore nga neni 277 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-se, nr.29178, 39/85, 57/89), ndërsa për marrëdhëniet e detyrimeve që janë lindur pas datës 19.12.20[12] është zbatuar dispozita nga neni 382 te Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, date 19.06.2012, kurse për kërkesat e palëve të treta ndaj Kompanive të Sigurimeve, ne rastet kur janë plotësuar kushtet ligjore pas hyrjes në fuqi (me datën 30 korrik 2011) të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 4, me datën 14 korrik 2011, janë zbatuar dispozita e këtij ligji.

Sipas Gjykatës Supreme "Rastet e kërkesave për kompensim të dëmit në bazë të së drejtës së subrogimit në praktiken e Gjykatës Supreme të Kosovës, varësisht nga koha e lidhjes se detyrimit janë shqyrtuar dhe vendosur në përputhje me dispozitat e ligjeve të cituara më sipër, me specifika përkatëse [...]."

84. Ndërsa përkitazi me përcaktimin e kamatëvonesës në lartësi prej 12%, Gjykata Supreme kishte sqaruar se:

"*Kamata në lartësi prej 12% të interesit vjetor zbatohet/llogaritet kur plotësohen kushtet ligjore në rastet e mos respektimit të afateve (neni 26 paragrafi 1 dhe 2, i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011) dhe mos përmbushjes së detyrimit (neni 26 paragrafi 4, i Ligjit të njëjtë) nga ana e siguruesve përgjegjës (Kompanitë e Sigurimeve) për çdo dite vonese deri në shlyerjen e detyrimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Situata e përshkruar sipas dispozitave nga neni 26 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i referohet përgjegjësisë që kanë Kompanitë e Sigurimeve ndaj palëve të treta, prandaj norma e vjetore e interesit në lartësi prej 12 % në këtë rast ka për synim që të nxitë një lloj qasje korrekte të Kompanive të Sigurimeve ndaj palëve të treta, në mënyrë*

që kërkesat për kompensimin e dëmeve të trajtohen brenda afateve ligjore, pëmdryshe Kompanitë e Sigurimeve do të paguajnë edhe interesin vjetor prej 12%.

Norma e interesit vjetor prej 12% ne raste te caktuara me ligj duhet të vlerësohet si një lloj ndëshkimi ndaj Kompanive te Sigurimeve, kur ato nuk janë të përgjegjshme ndaj palëve të treta, por nuk mund të konsiderohet si favorizim i kërkesës së kreditorit me të drejtë regresi ndaj debitorit me detyrim sepse marrëdhënia e kreditorit dhe e të detyruarit në pagesën e regresit është marrëdhënie e veçantë e detyrimeve dhe nuk është raporti i palës së tretë me Kompaninë e Sigurimeve, prandaj për kërkesën e palës së trete si palë e dëmtuar në raport me Kompaninë e sigurimeve në raste të caktuara mund të gjykohet norma e interesit vjetor prej 12%, por jo edhe për kërkesën e rimbursimit."

85. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata konsideron se përgjigja e dhënë nga Gjykata Supreme lidhur me interpretimin e saj se cili ligj do të zbatohet përkitazi me lartësinë e kamatëvonesës është në pajtueshmëri me arsyetimin e saj të dhënë në Aktgjykimin e kontestuar nga parashtruesi i kërkesës në rastin konkret. Prandaj, Gjykata konsideron se interpretimi dhe zbatim i dispozitave përkatëse ligjore në përcaktimin e kamatëvonesës nga Gjykata Supreme në rastin e parashtruesit të kërkesës hynë në sferën e ligjshmërisë, e që është në juridiksionin e kësaj gjykate. Thënë këtë, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj dhe sqarimit të dhënë në përgjigjen e saj ndaj pyetjes së Gjykatës ka arritur të shpjegojë raportin midis fakteve të paraqitura dhe zbatimit të ligjit në të cilin ajo është thirrur, gjegjësisht në çfarë mënyre ato vijnë në korrelacion me njëra tjetrën dhe se si kanë ndikuar ato në vendimin e Gjykatës Supreme që t'i ndryshojë vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët përkitazi me përcaktimin e lartësisë së kamatëvonesës.

86. Bazuar në si më sipër, Gjykata rithekson se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj të kontestuar ka adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës të paraqitura në kërkesën e tij, dhe për pasojë konsideron se nuk rezulton se procedurat e zhvilluara të kenë rezultuar në "konkluzione arbitrare" apo "qartazi të paarsyeshme" që do ta bënte vendimmarrjen e tyre të papajtueshme me standardet e një vendimi të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese ne rastin nr. KI55/19, parashtrues *Ramadan Osmani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 janarit 2020, paragrafi 46).

87. Duke vepruar kështu, Gjykata rithekson se Gjykata Supreme e ka përmbushur detyrimin e saj kushtetues për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor, sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje

me nenin 6 të KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së.

88. Prandaj, bazuar në si më sipër, konstaton se Aktgjykimi [Rev.nr.28/2019] i 1 gushtit 2019, i Gjykatës Supreme përkitazi me pretendimin për mosarseytim të vendimit gjyqësor nuk përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përfundime

89. Gjykata ka trajtuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar mbi këtë vlerësim praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së përkitazi me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit dhe parimin e sigurisë juridike në aspektin e konsistencës së praktikës gjyqësore, garanci këto, që me përjashtime të caktuara, janë të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

90. Së pari, sa i përket pretendimit që ndërlidhet me mosarsyetim të vendimit gjyqësor, Gjykata ka konstatuar se Aktgjykimi [E.Rev.nr.32/2019] i 31 korrikut 2019, i Gjykatës Supreme nuk është i përfshirë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe ka arsyetuar mjaftueshëm vendimin e saj.

91. Së dyti, sa i përket parimit të sigurisë juridike në kontekst të mungesës së konsistencës, përkatësisht divergjencës së praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme, Gjykata pasi shtjelloi parimet dhe kriteret themelore të GJEDNJ-së në këtë aspekt, aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret, dhe konstatoi se në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme nuk ka "dallime të thella dhe afatgjata" përkitazi me aplikimin e dispozitave ligjore që ndërlidhen me lartësinë e kamatëvonesës së aplikueshme në rastet e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, dhe rrjedhimisht konstatoi se nuk ishte cenuar parimi i sigurisë juridike, dhe se Aktgjykimi [E.Rev.nr. 32/2019] i 31 korrikut 2019 nuk ishte nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 prill 2021,

VENDOS

I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, E.Rev.nr.32/2019, i 31 korrikut 2019, është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

IV. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari që përgatiti Vendimin **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Safet Hoxha Arta Rama-Hajrizi

KI74/19, Parashtrues „Suva Rechtsabteilung", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 39/2018, të 8 janarit 2019

KI 74/19, Aktgjykim i 28 prillit 2021, publikuar më 22.06.2021

Fjalët kyç: *Kërkesa individuale, person juridik, kërkesë e pranueshme, vendim i kontestuar në pajtim me dispozitat kushtetuese*

Si pasojë e aksidentit që ishte shkaktuar nga i siguruari i kompanisë së sigurimeve EUROSIG në vitin 2010, i siguruari i parashtruesit të kërkesës M.H. pësoi dëme materiale. Parashtruesi i kërkesës i dërgoi një kërkesë EUROSIG, duke kërkuar kompensimin e dëmeve mbi bazën e regresit, të cilat u shkaktuan si rezultat i aksidentit të lartpërmendur të trafikut. Sipas kësaj kërkese, parashtruesi mori një ofertë nga EUROSIG e cila, sipas parashtruesit të kërkesës, nuk mbulonte dëmin e shkaktuar nga aksidenti i trafikut i cili ndodhi me fajin e të siguruarit të EUROSIG. Parashtruesi parashtroi padi kundër EUROSIG në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar që atij t'i paguhet një shumë e caktuar të hollash, përfshirë kamatëvonesën prej 20%, nga dita e ngritjes së padisë deri më 29 korrik 2011, ndërsa nga 29 korriku 2011 deri në pagesën përfundimtare kërkoi kamatëvonesën prej 12%. Gjykata Themelore në Prishtinë nxori Aktgjykimin, përmes të cilit aprovoi padinë e parashtruesit në tërësi. Megjithatë, Gjykata e Apelit ndryshoi pjesërisht aktgjykimin e Gjykatës Themelore vetëm në pjesën që lidhet me kamatëvonesën. Gjykata Supreme vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi që Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ishin nxjerrë në shkelje të të drejtave të tij për një vendim të arsyetuar, i cili gjithashtu shkaktoi shkelje të parimit të sigurisë juridike. Sipas parashtruesit të kërkesës, këto shkelje ndodhën për faktin se Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj nuk ofroi arsyetim të mjaftueshëm dhe adekuat për ndryshimin e qëndrimit në lidhje me llogaritjen e kamatëvonesës, qëndrim të cilin ajo vazhdimisht e kishte zbatuar në praktikën e saj gjyqësore.

Në lidhje me pretendimet për shkelje të parimit të sigurisë juridike, Gjykata konstatoi: (i) se në rastin konkret nuk ishte vërtetuar ekzistenca e dallimeve "të thella dhe afatgjata" përkitazi me konsistencën e praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme ; (ii) se ekziston mekanizmi për administrimin e duhur të drejtësisë dhe për shqyrtimin e dallimeve në praktikën gjyqësore (shih Ligjin për Gjykatat nr. 06/L-054, neni 14. 2.10); (iii) se Gjykata Supreme, më 1 dhjetor 2020, lëshoi një "Mendim Juridik për kamatën sa i përket ligjit të aplikueshëm, lartësisë dhe periudhës së llogaritjes" në bazë të nenit 14.2.10 të Ligjit për Gjykatat; (iv) që mundësia e vendimeve kontradiktore është një tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor të bazuar në një rrjet të gjykatave

themelore dhe të apelit me autorizime brenda juridiksionit të saj territorial; (v) dhe se cili ligj duhet të aplikohet në rrethanat e rastit konkret është prerogativë dhe detyrë e Gjykatës Supreme; dhe (vi) se roli i Gjykatës Supreme është pikërisht të zgjidhë konflikte të tilla.

Në lidhje me pretendimet për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, Gjykata konstatoi se (i) Gjykata Supreme deklaroi bazën ligjore dhe shpjegoi pse në rastin e parashtruesit të kërkesës aplikohet norma e cila përcakton kamatëvonesën "e thjeshtë" që paguhet për mjetet e kursimeve të afatizuara për një periudhë më të gjatë se një vit pa destinim të caktuar; (ii) që aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmban lidhjen logjike midis bazës ligjore, arsyetimit dhe konkluzioneve të nxjerra; (iii) që, si një rrjedhë logjike midis bazës ligjore, arsyetimit dhe konkluzioneve, rezultoi që aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme plotëson kriterin e një vendimi të arsyetuar; dhe (iv) çështja nëse parashtruesit të kërkesës i është njohur e drejta për kamatëvonesë të "kualifikuar" prej 12% ose për kamatë "të thjeshtë" e cila paguhet për mjetet e depozituara me një afat më të gjatë se një vit pa destinim të caktuar, është çështje e aplikimit dhe interpretimit të ligjit dhe diskrecionit të Gjykatës Supreme në gjykim, e cila, si e tillë, nuk është në vetvete në kundërshtim me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Gjykata konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI74/19

Parashtrues

"SUVA Rechtsabteillung"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 39/2018, të 8 janarit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLLKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Kompania e Sigurimeve "SUVA Rechtsabteillung" (në tekstin e mëtejmë: "SUVA Rechtsabteillung") nga Zvicra (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilën e përfaqësojnë Visar Morina nga Prishtina dhe avokati Besnik z. Nikqi nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E. Rev. nr. 39/2018] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) të 8 janarit 2019, në lidhje me Aktgjykimin [Ae. nr. 91/2016] e Gjykatës së Apelit të 31 gushtit 2018, dhe Aktgjykimin [III. C. nr. 506/2012] e Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) të 8 shkurtit 2016.

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Më 7 maj 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

5. Më 10 maj 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Remzije Istrefi-Peci.

6. Më 30 maj 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.

7. Më 22 tetor 2020, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme që të njoftohet për praktikën gjyqësore lidhur me aplikimin e kamatëvonesës në kontestet e subrogimit të borxhit. Kërkesa drejtuar Gjykatës Supreme përveç rastit nën shqyrtim KI74/19 ndërlidhej edhe me rastet e tjera por të natyrës së ngjashme KI111/19, KI09/20 dhe KI113/20.

8. Më 2 dhjetor 2020, Gjykata Supreme dorëzoi "Mendim Juridik për Kamatën i miratuar në mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 1 dhjetorit 2020, bazuar në nenin 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për gjykatat". Pjesët relevante të Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme janë paraqitur në tekstin e mëtejmë të këtij Aktgjykimi.

9. Më 28 prill 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe vlerësimin e meritave.

10. Po të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, deklaroi kërkesën si të pranueshme dhe, me shumicë votash konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 26 korrik 2010, ka ndodhur një aksident i trafikut në të cilin ishin të përfshira dy automjete të pasagjerëve dhe me atë rast automjeti (në pronësi të O.D.) me tabela të regjistrimit të Kosovës dhe me sigurimin e automjeteve të Kompanisë së Sigurimeve EUROSIG (në tekstin e mëtejmë: EUROSIG) i shkaktoi dëme automjetit të pasagjerëve (në pronësi të M.H., të siguruarit të parashtruesit të kërkesës) me tabela të regjistrimit të Zvicrës dhe sigurimin e automjeteve të "SUVA Rechtsabteillung".

12. Më 16 maj 2011, parashtruesi i kërkesës i dërgoi një kërkesë kompanisë EUROSIG, me të cilën kërkoi kompensimin e dëmit mbi bazën e regresit, i cili është shkaktuar si rezultat i aksidentit të lartpërmendur të trafikut. Sipas kësaj kërkese, parashtruesi i kërkesës mori një ofertë nga kompania EUROSIG, e cila, sipas parashtruesit të kërkesës, nuk e mbulonte dëmin e shkaktuar nga aksidenti i trafikut i cili ndodhi me fajin e të siguruarit të kompanisë EUROSIG.

13. Më 21 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër kompanisë EUROSIG, në të cilën kërkoi që në emër të dëmit të shkaktuar t'i paguhet shuma prej 50,858.62 €, me kamatëvonesën prej 20% dhe atë duke filluar nga data 16 maj 2011, përkatësisht nga dita e paraqitjes së padisë e deri më 29 korrik 2011, ndërsa nga data 29 korrik 2011 e deri në pagesën definitive kërkoi kamatëvonesën prej 12 %.

14. Më 8 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë nxori Aktgjykimin III. C. nr.506/2012, me të cilin e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në tërësi. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet:

> *"Meqenëse shkaktar i aksidentit ka qenë i siguruari i të paditurit, duke ju referuar nenit 300 dhe nenit 939 të LMD-së, gjykata e detyroj që sipas të drejtës së subrogimit t'iaregresoi paditësit shumën e dëmit të cilin e shkaktoi i siguruari i tij.*
> *Andaj, gjykata duke u bazuar nga të cekurat më lartë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është bazuar andaj të njëjtën e ka aprovuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.*
> *Meqenëse i padituri ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e dëmit të krijuar, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, gjykata e detyroi paditurin që t'ia paguaj paditësit shumat e gjykuara të kompensimit së bashku me normën e kamatës, në lartësi prej 20% e cila u llogarit nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim tek e paditura 16.05.2011 e deri me datë 29.07.2011. Koha për të cilën është caktuar kjo kamatë për vonesë gjykata e ka llogaritur në përputhje me Nenin 5.1 të Rregullit 3 mbi ndryshimin e Rregullit për sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Ndërsa nga data 29.07.2011 e deri në pagesën definitive do të llogaritet kamata vjetore prej 12% konformë nenit 26-6 të Ligjit 04/L-018 mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia".*

15. Në një datë të pacaktuar, EUROSIG paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit për kamatën, vendimit për shpenzimet e procedurës dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigjen e tij ndaj ankesës dhe propozoi që ankesa e kompanisë EUROSIG të shpallet e pabazuar.

16. Më 31 gusht 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit Ae. nr.91/2016, refuzoi, si të pabazuar, ankesën e kompanisë EUROSIG dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (i) lidhur me borxhin kryesor mbi bazën e subrogimit në shumë prej 50,858.62 euro dhe ndryshoi Aktgjykimin në fjalë (ii) sa i përket kamatëvonesës, duke e detyruar kompaninë EUROSIG që të paguajë kamatën "*të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuar në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar*" me një dënim shtesë në shumë prej 20% nga 16 maji 2011 e deri më 29 korrik 2011, ndërsa duke filluar prej 30 korrikut 2011 e deri në pagesën definitive, vetëm kamatëvonesën me normë vjetore prej 12%. Gjykata e Apelit shpjegoi se ulja e

kamatëvonesës nga 20% në 12% pas 30 korrikut 2011, është rezultat i hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm).

17. Në një datë të pacaktuar, EUROSIG paraqiti kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe tejkalimit të kërkesëpadisë.

18. Më 8 janar 2019, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin E. Rev. nr. 39/2018, me të cilin:

> *"Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 91/2016 datë 31.08.2018. [...] dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 91/2016 datë 31.08.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III. C. nr. 506/2012 datë 08.02.2016, ashtu që shumën e gjykuar me këto aktgjykime në lartësi prej 50.858,62 €, detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë me kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 24.01.2012 e tutje deri në përmbushjen përfundimtare të këtij borxhi."*

19. Gjykata Supreme në paragrafin e dytë të dispozitivit, i cili ka të bëjë me ndryshimin e Aktgjykimit të gjykatave të shkallëve më të ulëta, theksoi:

> *"[...] aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë në pjesën lidhur me kamatën e gjykuar përfshihet me zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 277 të LMD të vjetër në lidhje me nenin 26.7 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, nr. 04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011.*
> *Zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, qëndron në faktet se, si është thënë më lartë, kërkesa e paditësit për kompensim si dhe padia është paraqitur në kohën kur ka hyrë në fuqi Ligji i lartpërmendur për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Andaj kamata e aprovuar nga gjykata e shkallës së dytë dhe gjykata e shkallës së parë, ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për regresim borxhi, por vetëm për vonesa të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblimin e dëmit në procedurë jashtë gjyqësore ashtu siç parashihet në nenin 26 të*

Ligjit të lartpërmendur dhe nenin 5.1 të Rregullit të BQK-së nr. 3 mbi ndryshimin e rregullit për sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësisë të datës 25 shtator 2008, në të cilat dispozita thirret gjykata e shkallës së dytë. Ato kamata të cilat i ka aplikuar gjykata e shkallës së parë dhe e dytë janë të parapara me qëllim të disiplinimit të kompanive siguruese në raportet e sigurimit ndaj kërkesave për dëmshpërblim të personave të dëmtuar, të cilat kërkesa kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që t'i trajtojnë me urgjencë brenda afateve të parapara sipas dispozitave të lartpërmendura.
Paragrafi 7 i nenit 26 të Ligjit të lartpërmendur përjashton zbatimin e kamatës prej 12% edhe për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mos trajtimin dhe rënien në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar, për dëmshpërblim. Kështu që, pa dyshim rezulton se paditësi ka të drejtë vetëm në kamatën e thjeshtë, e jo edhe në kamatë "të kualifikuar" sipas dispozitave të cituara nga gjykata e shkallës së parë dhe të dytë."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin E. Rev. nr. 39/2018 është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së janë shkelur për shkak të mungesës së arsyetimit të Aktgjykimit, përkatësisht se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm dhe adekuat përkitazi me ndryshimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ae. nr. 91/2016 lidhur me kamatëvonesën, dhe konsideron se me këtë është shkelur parimi i së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

22. Parashtruesi i kërkesës në veçanti thekson se nuk është e qartë se "*mbi cilën bazë juridike Gjykata Supreme konstaton se:*

"- gjykatat e instancave më të ulëta kanë gabuar në zbatimin e të drejtës materiale dhe arsyetimi përkatës lidhur me këtë, si dhe - të referuarit nga kjo Gjykatë në Paragrafin 7 të Nenit 26 të Ligjit 04/L-018 rezulton të jetë i dështuar me faktin se dispozita e përmendur (Paragrafi 7) as që trajton këtë çështje e më së paku korrespondon me përmbajtjen e cituar në arsyetimin e Aktgjykimit [E. Rev. nr. 39/2018 të datës 08.01.2019]. Për më tepër, ky qëndrim i Gjykatës Supreme është tërësisht ndryshe

nga vendimet e saja të mëparshme, duke përjashtuar Aktgjykimin [E. Rev. nr. 27/2017 të datës 24.01.2018], i cili për shkaqe të njëjta është anuluar me Aktgjykimin AGJ 1347/2019 (Rasti KI. 87/18) e datës 15.04.2019 nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës."

23. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se *"aktgjykimi i Gjykatës Supreme të cilin e konteston është në kundërshtim edhe me praktikën e saj gjyqësore, pasi referuar praktikës së saj gjyqësore në situata të njëjta rezulton se Gjykata Supreme pa rezervë i referohet dhe zbaton rregullativen respektive „lex specialis" nga kjo lëmi (BQK Rregulli Nr. 3 mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë) me rastin e trajtimit të institutit të kamatëvonesës".*

24. Në mbështetje të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë disa aktgjykime të Gjykatës Supreme për të treguar se Gjykata Supreme nuk e kishte ndjekur praktikën e saj gjyqësore. Aktgjykimet e dorëzuara të Gjykatës Supreme janë: *„[E. Rev. Nr. 27/2017] i datës 24.01.2018, [E. Rev. Nr. 23/2017 i datës 23 Dhjetor 2017], [E. Rev. Nr. 48/2014 i datës 13 maj 2014], [E. Rev. Nr. 62/2014 i datës 21 janar 2015], [E. Rev. Nr. 14/2016 i datës 24 mars 2016], [E. Rev. Nr. 06/2015 idatës 19 mars 2015], [E. Rev. Nr. 55/2014 i datës 3 nëntor 2014] dhe [E. Rev. Nr. 20/2014 i datës 14 Prill 2014]".*

25. Kur bëhet fjalë për parimin e sigurisë juridike dhe konsistencës në vendimmarrje, parashtruesi i kërkesës deklaron: "*Gjykata Supreme nxori aktgjykime me arsyetime të ndryshme ligjore në çështje identike, duke ndikuar drejtpërdrejt në modifikimin e lartësisë së interesit të caktuar. (Shih aktgjykimet e shënuara më sipër dhe periudhën kohore të treguar). Këto hezitime në procedurën e marrjes së një vendimi gjyqësor të shkallës më të lartë të gjykatës rrezikojnë drejtpërdrejt parimin e sigurisë juridike".*

26. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme E. Rev. 39/2018, të 8 janarit 2019, për shkak të shkeljes së nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe ta kthejë çështjen në rishqyrtim.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2.Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]".

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]".

LIGJI MBI MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE *(Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85, 57/89)*

„[...]

III. Kamatëvonesa
Kur ka debitim

Neni 277

(1) Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos kryegjësë, edhe kamatën sipas shkallës së përcaktuar me ligjin federativ.

(2) Në qoftë se shkalla e kamatës kontraktuese është më e lartë nga shkalla e kamatëvonesës, ajo rrjedh edhe pas vonesës së debitorit.

[...]

Nënpjesa 2

Vonesa

Vonesa e debitorit

Kur debitori është në vonesë

Neni 324

(1) Debitori është në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar për përmbushje.

(2) Në qoftë se afati për përmbushje nuk është caktuar, debitori është në vonesë kur kreditori ta ftojë që ta plotësojë detyrimin e vet, verbalisht ose me shkrim, paralajmërim jashtëgjyqësor, ose duke filluar ndonjë procedurë, qëllimi i së cilës është realizimi i përmbushjes së detyrimit.

[...] ”

LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE i 19 korrikut 2012

PJESA XXX

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 1057

Zbatimi i këtij ligji

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

[...] ”

LIGJI NR. 04/L-018 PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGJEGJËSIA

Neni 26
Procedura e kërkesave për dëmshpërblim

1. *Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me:*

1.1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse;

1.2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit.

2. Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e kompletuar me prova dhe dokumentacion të nevojshëm për të vendosur për dëmshpërblimin, siguruesi është i detyruar që, më së largu në afat prej tri (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për dëmshpërblim, të njoftojë me shkrim të dëmtuarin duke precizuar me cilat nga provat dhe dokumentacioni duhet plotësuar kërkesën. Prej ditës së pranimit, respektivisht kompletimit të dokumentacionit të kërkesës, fillojnë të zbatohen afatet nga paragrafi 1. i këtij neni për detyrimin e siguruesit përkitazi me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.

3. BQK-ja nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e procedurave për dëmshpërblim, duke përfshirë edhe përcaktimin se kur konsiderohet e kompletuar kërkesa me prova dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vendosur lidhur me dëmshpërblimin.

4. Në pamundësi të përcaktimit të dëmit, respektivisht trajtimit të dëmshpërblimit në tërësi, siguruesi përgjegjës është i detyruar t'i paguajë palës së dëmtuar pjesën jokontestuese të dëmit në formë paradhënie, brenda afatit nga paragrafi 1. i këtij neni.

5. Në rast se siguruesi përgjegjës nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në Gjykatën Kompetente.

6. Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

7. Dispozitat nga paragrafi 1., 2., 4. dhe 5. të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në rastet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim të cilat janë detyrim i byrosë për dëmet nga baza e sigurimit kufitar dhe detyrimet e Fondit të kompensimit.

8. Në kërkesat për dëmshpërblim nga sistemi i kartonit ndërkombëtar të sigurimit zbatohen procedura dhe afate të posaçme sipas Marrëveshjes së Kretës.

Ligji për Gjykatat nr. 06/L-054, i cili në nenin 14 parasheh një mekanizëm për menaxhimin e duhur të gjyqësorit dhe shqyrtimin e dallimeve në praktikën gjyqësore

Neni 14
Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryetarit dhe nënkryetarit të Gjykatës

"[...]
2.10. Kryetari i gjykatës thërret takim vjetor të të gjithë gjyqtarëve për këshillim mbi Administrimin e Drejtësisë në atë gjykatë; për të analizuar organizimin e gjykatës; për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika".

Rregulla III e Bankës Qendrore të Kosovës mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë, e 25 shtatorit 2008

Neni5
Rregullimi i dëmeve

5.1 Rregullimi

Kërkesat për zhdëmtim të bazuara në sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë në pajtim me dispozitat e kësaj rregulle,

përfshirë regresin nga fondi garantues duhet të zgjidhen në një periudhë kohore prej 10 ditësh prej ditës së parashtrimit të provave të nevojshme dhe dokumentacionit relevant që kërkohen nga kompania e sigurimit apo nga fondi garantues, duke iu referuar zhdëmtimit të dëmeve që kanë pasojë vdekjen, lëndime trupore apo humbjen e pasurisë. Fondi Garantues apo një kompani e sigurimit e cila nuk e rregullon dëmin valid brenda periudhës kohore prej dhjetë (10) ditësh, duhet të paguaj dënimin e barabartë me 20% të kamatës vjetore të llogaritur nga data e raportimit të dëmit deri në datën kur zhdëmtimi është paguar apo rregulluar. [...]"

Mendim Juridik për Kamatën i miratuar në mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës i 1 dhjetorit 2020, i bazuar në nenin 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat

PJESA E PARË
Ligji i aplikueshëm

III. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85,57/89).

IV. Për marrëdhëniet që kanë lindur pas datës 19.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012.

PJESA E DYTË

VII. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore për të gjitha kërkesat caktohet si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar.

VIII. [...]

IX. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 19.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore për të gjitha kërkesat do të caktohet në lartësi prej 8 %, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.
IX. Për kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit nga të gjitha bazat e përgjegjësisë kur kreditorët kanë të drejtë në

rimbursim të dëmit, lartësia e kamatës caktohet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik, varësisht se cili ligj është zbatuar (ka qenë në fuqi) kur kreditori në cilësinë e debitorit ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë.

Situatat kur aplikohet norma e interesit vjetor prej 12 %:

- *Kur kërkesat e paraqitura tek Kompanitë e Sigurimeve, për dëmin në persona, nuk trajtohen në afat prej 60 ditësh;*

- *Kur kërkesat e paraqitura tek Kompanitë e Sigurimeve, për dëmin në pasuri, nuk trajtohet brenda 15 ditësh;*

Arsyetimi i Mendimit Juridik

Arsyetimi për pikën IX (nëntë) të mendimit juridik- *Në praktikën gjyqësore paraqiten raste të shpeshta të kreditorëve për rimbursim të dëmit të cilët kanë përmbushur detyrimet paraprakisht ndaj palëve të treta, e të cilat kryesisht ndërlidhen me rastet e siguruara nga kompanitë e sigurimeve vendore me kompanitë e huaja. Për këtë lloj të kërkesave në praktikën e gjykatave është vërejtur interpretim dhe zbatim i dispozitave ligjore në disa forma sa i përket shkallës/lartësisë së kamatëvonesës për rastet e kërkesave për rimbursim. Kjo ka ndodhur për shkak se kreditorët me rastin e paraqitjes së kërkesave për rimbursim të dëmit duke iu referuar nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, kanë kërkuar që rimbursimi i kërkesës të bëhet me normë vjetore prej 12%, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës në Seancën e Përgjithshme të saj përmes këtij mendimi juridik ka vlerësuar se nuk mund të aplikohet norma/kamatëvonesa vjetore prej 12% në të gjitha rastet. Kjo për shkak se kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit kryesisht u referohen situatave për marrëdhëniet juridiko-civile (jokontraktuale për kreditorin dhe debitorin), prandaj, në një rast të tillë sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kamatëvonesa vjetore duhet të paguhet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik. Kjo nënkupton se në rast se kreditori ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë, para datës 20.12.2012, norma e interesit do të zbatohet si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, ndërsa në rast se kreditori ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë pas datës 19.12.2012, atëherë*

shkalla/lartësia e kamatëvonesës do të zbatohet në shkallë prej 8%.

Përveç të cekurave, Gjykata Supreme vlerëson se shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore prej 12%, nuk mund të zbatohet edhe për shkak të faktit se sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare me nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, interesi vjetor 12%, vjen në shprehje për shkak të neglizhencës së kompanive të sigurimeve (të cilat pastaj paraqiten si kreditor regresues), sepse sikur kreditorët regresues t'i kishin trajtuar konform përgjegjësive ligjore kërkesat e palëve të treta, ndaj tyre nuk do të mund të zbatohej shkalla/lartësia e kamatëvonesës prej 12%, në vendimet e gjykatës, por do të zbatohej shkalla/lartësia si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, apo shkalla/lartësia prej 8%, varësisht se cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e lindjes së marrëdhënies së detyrimit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

29. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".*

30. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u referuar në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të cilat vlejnë për

individët dhe për personat juridikë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës: *Universiteti AAB-RIINVESTL.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

31. Për më tepër, Gjykata i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

32. Gjatë vlerësimit të kushteve të lartpërmendura, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë si për individët ashtu edhe personat juridikë për aq sa janë të zbatueshme (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI118/18, parashtrues, *Eco Construction sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 tetorit 2019, paragrafi 29; dhe KI41/09, *parashtrues Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14). Prandaj, Gjykata

konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [E. Rev. 39/18] të Gjykatës Supreme të 8 janarit 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj.

33. Gjykata vëren se Aktgjykimi [E. Rev. 39/18] i Gjykatës Supreme është i 8 janarit 2019, ndërsa kërkesa në shqyrtim është parashtruar më 7 maj 2019, që do të thotë se është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

34. Gjykata gjithashtu konsideron që parashtruesi i kërkesës ka deklaruar saktësisht cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ janë shkelur në dëm të tij, në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 48 të Ligjit.

35. Prandaj, Gjykata konkludon që parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; se ai ka shteruar të gjitha mjetet juridike; se ai ka respektuar kushtin e paraqitjes së kërkesës brenda afatit ligjor; se ai theksoi saktësisht shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; dhe gjithashtu, tregoi se cilin akt specifik të organit publik po e konteston.

36. Duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesit dhe argumentet e tyre, Gjykata konsideron që kërkesa ngre çështje serioze kushtetuese dhe se përcaktimi i tyre varet nga shqyrtimi i meritave të kërkesës. Gjithashtu, kërkesa nuk mund të konsiderohet qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe nuk është vërtetuar asnjë bazë tjetër për ta deklaruar atë të papranueshme (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017).

37. Gjykata e deklaron kërkesën të pranueshme për shqyrtim të meritave.

Meritat e kërkesës

38. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme është shkelur e drejta e tij për vendim të arsyetuar, që gjithashtu shkaktoi shkelje të parimit të sigurisë juridike. Sipas parashtruesit të kërkesës, këto shkelje ndodhën për shkak se Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj nuk ofroi një arsyetim të mjaftueshëm dhe adekuat për ndryshimin e

qëndrimit në lidhje me llogaritjen e kamatëvonesës, të cilin ajo vazhdimisht e kishte zbatuar në praktikën e saj.

39. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se mbetet i paqartë dhe i pashpjegueshëm fakti se mbi të cilën bazë ligjore Gjykata Supreme e bazoi Aktgjykimin e saj për ndryshimin e kamatëvonesës të gjykuar nga gjykatat më të ulëta.

40. Parashtruesi i kërkesës shton se Aktgjykimit të Gjykatës Supreme i mungon arsyetimi përkatës i qasjes së re në këtë rast, në lidhje me institutin e kamatëvonesës në marrëdhëniet juridike të sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësisë sepse Gjykata Supreme ka vendosur krejtësisht ndryshe në raste të njëjta.

41. Duke pasur parasysh pretendimet e bëra në kërkesën në shqyrtim, Gjykata i referohet nenit 31.1 dhe 2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> "1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*"

42. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), të KEDNJ-së që parasheh:

> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij."*

43. Gjykata përsërit se bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë. Në pajtim me këtë, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31

të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

(i) Parimet e përgjithshme përkitazi me sigurinë juridike dhe konsistencën e praktikës gjyqësore

44. GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore ka përcaktuar se nuk është funksioni i saj të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë vendore, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Konventën Evropiane (shih *García Ruiz kundër Spanjës,* cituar më lart, paragrafi 28). Po ashtu, nuk është funksioni i saj as t'i krahasojë, përveç në rastet e arbitraritetit të dukshëm, vendimet e ndryshme të gjykatave kombëtare, madje edhe nëse ato janë nxjerrë në procedurat që janë dukshëm të ngjashme, pasi që pavarësia e këtyre gjykatave duhet të respektohet (shih rastin e GJEDNJ-së *Ādamsons kundër Letonisë*, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118).

45. Mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor të bazuar mbi rrjetin e gjykatave themelore dhe të apelit me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial. Një shmangie e tillë mund të ndodhë edhe brenda të njëjtës gjykatë. Kjo, në vetvete, nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me Konventën (shih rastet e GJEDNJ-së *Santos Pinto kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41; dhe *Tudor Tudor kundër Rumanisë*, cituar më lart paragrafi 29).

46. Megjithatë, GJEDNJ në praktikën e saj ka vendosur kritere të cilat ajo i përdor për të vlerësuar nëse vendimet kundërthënëse të gjykatave vendore, duke gjykuar në instancën e fundit, shkelin kërkesën për gjykim të drejtë të parashikuar me nenin 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane, e ato kritere janë: ***i)*** *përcaktimi nëse ekzistojnë „dallime të thella dhe afatgjata" në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit*, ***ii)*** *nëse ligjet e vendit parashohin një mekanizëm i cili mund t'i tejkalojë këto kundërthënie*, ***iii)*** *nëse ky mekanizëm është zbatuar, dhe nëse po, në çfarë mase* (shih aktgjykimet e GJEDNJ-së *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, par. 49-50; *Beian kundër Rumanisë* (numër 1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, par. 34-40; *Ştefan dhe Ştef kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 27 janarit 2009, par. 33-36; *Schwarzkopf dhe Taussik kundër Republikës Çeke,* vendim për pranueshmëri i 2 dhjetorit 2008; *Tudor Tudor*, i cituar në tekstin e mësipërm, paragrafi 31; dhe *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 2 nëntorit 2010, paragrafi 36).

(ii) Parimet e përgjithshme mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar

47. Gjykata, para së gjithash, rikujton se garancitë e përmbajtura në nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së, përfshijnë detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre. Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *H. kundër Belgjikës,* aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53).

48. Gjykata, gjithashtu, thekson se sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 6, paragrafi 1 i detyron gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga gjykatat të kërkohet përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës,* Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, vendim për pranueshmëri i 29 gushtit 2000).

49. Lidhur me këtë, GJEDNJ shton se gjykata vendore ka një liri të caktuar të vlerësimit në pranimin e argumenteve dhe vendosjen në pranueshmërinë e provave, por ajo gjithashtu ka edhe obligimin që të justifikojë veprimet e saj duke dhënë arsyetime për vendimet e saj (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa 37801/97, e 1 korrikut 2003, paragrafi 36).

50. Gjithashtu, Gjykata thekson se në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, gjatë shqyrtimit nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i plotëson standardet e të drejtës për gjykim të drejtë, duhet të merren parasysh rrethanat e rastit konkret. Vendimi gjyqësor nuk duhet të jetë pa asnjë arsyetim, dhe as arsyetimi nuk duhet të jetë i paqartë. Kjo posaçërisht vlen për arsyetimin e vendimit të gjykatës e cila vendos sipas mjetit juridik, në të cilin janë ndryshuar qëndrimet juridike të paraqitura në vendimin e gjykatës më të ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës,* cituar më lart, paragrafi 61).

51. Gjykata dëshiron të theksojë se nocioni i një gjykimi të drejtë, në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, gjithashtu kërkon që gjykata kombëtare e cila ka dhënë arsye të pakta për vendimet e saj, në të vërtetë të ketë adresuar çështjet themelore në kuadër të juridiksionit të saj, pra se nuk i kishte pranuar thjeshtë dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët. Kjo kërkesë është edhe më e rëndësishme në rast kur një palë në kontest nuk ka pasur mundësi për të paraqitur gojarisht rastin e saj në procedurën vendore

(shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Helle kundër Finlandës,* kërkesa 157/1996/776/977, e 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60).

52. Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih, Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI97/16 *IKK Classic*, Aktgjykimi i 11 janarit 2018).

(iii) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në lidhje me sigurinë juridike dhe të drejtën në vendimin e arsyetuar në rrethanat e rastit konkret

53. Gjykata vëren se pretendimi kryesor ankimor i parashtruesit të kërkesës është se Gjykata Supreme, nuk ka deklaruar arsye të qarta dhe të mjaftueshme mbi të cilat ka mbështetur vendimin e saj për të ndryshuar aktgjykimet e gjykatave më të ulëta në lidhje me llogaritjen e lartësisë së kamatëvonesës në rastin e parashtruesit të kërkesës dhe duke mos arsyetuar se pse kishte marrë një vendim ndryshe në raport me praktikën e saj të mëparshme, ka shkelur parimin e sigurisë juridike të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së.

54. Gjykata vlerëson se në rastin konkret pretendimet në lidhje me sigurinë juridike dhe te drejtën ne vendimin e arsyetuar , për shkak të natyrës së rastit dhe marrëdhënies së tyre të ndërlidhur, duhet të shqyrtohen në kontekstin e një arsyetimi të vetëm. Gjykata rikujton që Gjykata Supreme (Aktgjykimi E. Rev. 39/18) ndryshoi Aktgjykimet a shkallëve më të ulëta (Gjykatës së Apelit Ae. nr. 91/2016 të 31 gushtit 2018 dhe të Gjykatës Themelore III. C. nr. 506/2012 të 8 shkurtit 2016) vetëm në lidhje me vendimin për kamatën e gjykuar.

55. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme deklaroi: "*Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 91/2016 datë 31.08.2018 dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 91/2016 datë 31.08.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike III. C. nr. 506/2012 datë*

08.02.2016, ashtu që shumën e gjykuar me këto aktgjykime në lartësi prej 50.858,62 €, detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë me kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 24.01.2012 e tutje deri në përmbushjen përfundimtare të këtij borxhi".

56. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se për të mbështetur pretendimin e tij për shkelje të parimit të sigurisë juridike, parashtruesi i kërkesës dorëzoi tetë (8) vendime të Gjykatës Supreme në raste të ngjashme që kanë të bëjnë me çështjen e regresit dhe kamatëvonesës, përkatësisht:) [E. Rev. nr. 27/2018 i 24 shtatorit 2018]; (2) [E. Rev. nr. 23/2017 i 14 dhjetorit 2017], (3) [E. Rev. nr. 48/2014 i 13 majit 2014], (4) [E. Rev. nr. 62/2014 i 21 janarit 2015], (5) [E. Rev. nr. 14/2016 i 24 marsit 2016]; (6) [E. Rev. nr. 6/2015 të 19.03.2015], (7) [E. Rev. nr. 55/2014 i 3 nëntorit 2014] dhe (8) [E. Rev. nr. 20/2014 i 14 prillit 2014].

57. Në vijim, Gjykata do të rikujtoje pjesët përkatëse të disa prej vendimeve të sipërpërmendura.

58. Në Aktgjykimin e E. Rev. nr. 27/2018 të 24 shtatorit 2018, Gjykata Supreme në pjesën përkatëse arsyetoi: "*Ndërkohë që Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, përkitazi me kamatën e gjykuar është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndaj, edhe e ndryshoi të njëjtin në këtë pjesë, duke e lënë në fuqi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Kështu nga se, Gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale kur paditësit i ka pranuar të drejtën në kamatë në shumën e gjykuar në lartësi prej 20% duke filluar nga dt. 15.04.2011 e deri me dt, 29.07.2011 dhe kamatën prej 12% duke filluar nga dt. 29.07.2011 e deri në pagesën definitive nga se sipas dispozitës së nenit 277 të LMD-së dhe nenit 26.6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, me të cilën dispozitë është paraparë se në rastin e mosrespektimit të afateve të përcaktuara në par. 1 të këtij neni dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga par. 4 të këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë me vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke e ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë, ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim".*

59. Në Aktgjykimin E. Rev. 23/2017, të 14 dhjetorit 2017, Gjykata Supreme në pjesën përkatëse arsyetoi: *"Kjo lartësi e kamatës ka qenë e paraparë deri në hyrje në fuqi të Ligjit për Sigurimin e*

Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia (nr 04/L-018) e cila ka hyrë në fuqi më 30.07.2011 dhe kjo datë duhet të llogaritet kamata prej 12% në bazë të nenit 26 pika 6. Gjykata e shkallës së dytë ka llogaritur kamatën në shumën e gjykuar në lartësi që paguajnë bankat në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar si dhe kamatën në bazë të Rregullit 3 të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) dhe Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia".

60. Në Aktgjykimin E. Rev. nr. 48/2014, të 27 tetorit 2014, Gjykata Supreme në pjesën përkatëse arsyetoi: "*Kjo Gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë aplikuar të drejtën materiale kur paditësit i kanë pranuar të drejtën në kamatë në shumën e borxhit kryesor në lartësi prej 20% vjetore duke filluar nga data 19.11.2010 e deri me datën 28.07.2011 dhe kamatën prej 12% duke filluar nga dt. 29.07.2011 e deri në pagesën definitive nga se sipas dispozitës së nenit 277 të LMD-së dhe nenit 26.6 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia nr. 04/L-018, me të cilën dispozitë është paraparë se në rastin e mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4 të këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë me vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke e ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë, ky interes paguhet në lartësinë prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim".*

61. Në Aktgjykimin E. Rev. nr. 62/2014 të 21 janarit 2015, Gjykata Supreme në pjesën përkatëse arsyetoi: "*Kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së dytë drejt ka aplikuar të drejtën materiale kur të padituës ia ka pranuar të drejtën në kamatë në shumën e borxhit kryesor në lartësi prej 12% duke filluar nga data 14.6.2010 e deri në pagesën definitive ngase sipas dispozitës së nenit 277 të LMD-së e lidhur me nenin 26.6 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia nr. 04/L-018, parashihet kamata në lartësi prej 12% në vit e cila llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi, duke llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim".*

62. Në Aktgjykimin E. Rev. nr. 14/2016 të 24 marsit 2016, Gjykata Supreme në pjesën përkatëse arsyetoi: "*Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 40/2015 datë 12.11.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të padituës ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike C. nr. 544/2013 datë 23.12.2014 me të cilin me pjesën I të*

diapozitivit është miratuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit që të detyrohet Kompania e Sigurimeve "Insig" me seli në Prishtinë, që paditësit t'ia kompensojë shumën prej 42.243.41 € në emër të regresit nga sigurimi i auto përgjegjësisë, me kamatë prej 12% në vit, duke e llogaritur nga data 14.1.2010 e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi [...] Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se: Revizioni është i pabazuar".

63. Në Aktgjykimin E. Rev. nr. 6/2015 të 19 marsit 2015, Gjykata Supreme në pjesën përkatëse arsyetoi: "*Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 162/2013 datë 10.06.2014 është refuzuar si e pabazuar ankesa e të padituës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike C. nr. 229/2012 datë 16.07.2013, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që paditësit t'i paguajë shumën prej 17.924.35 € në emër të kompensimit të dëmit kasko regres lidhur me riparimin e automjetit të dëmtuar të tipit "BMW 5" me targa ES VS 2009 në aksidentin e datës 25.08.2009, pronar i të cilës ishte V.J. i cili klithe siguruar këtë automjet me sigurim kasko tek e paditura, me kamatë ndëshkuese prej 12%, duke filluar nga data 22.07.2010 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.134.29 € [...] Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë të goditur me revizion, në kuptim të nenit 215 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), dhe gjeti se: Revizioni i të padituës është i pabazuar".*

64. Në Aktgjykimin E. Rev. nr. 55/2014 të 3 nëntorit 2014, Gjykata Supreme në pjesën përkatëse arsyetoi: "*Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 46/2013 të datës 10.05.2014, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të padituës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike e Qarkut në Prishtinë C. nr. 282/2012 të datës 09.10.2012 me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura, që të paguajë në emër të borxhit regresiv shumën prej 14.041.58 €, me kamatë vjetore prej 12% [...]Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur, sipas dispozitës së nenit 215 të LPK, vlerësoi se: Revizioni është i pabazuar".*

65. Në Aktgjykimin E. Rev. nr. 20/2014 të 14 prillit 2014, Gjykata Supreme në pjesën përkatëse arsyetoi: "*Edhe thëniet e të padituës në revizion se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale kur paditëses i kanë pranuar të drejtën me kamatë në lartësinë e shumës së aprovuar në lartësi prej 12% vjetore janë të*

pabazuara, ngase gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë aplikuar të drejtën materiale dhe atë dispozitën e nenit 277 të LMD-së lidhur me nenin 26 pika 6 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia nr. 04/L-018 me të cilën dispozitë është paraparë se në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në parag. 1 të këtij neni dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4 i këtij neni siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12% të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim".

66. Në rastet e lartpërmendura, Gjykata Supreme, ka arsyetuar se neni 26.6 i Ligjit në fjalë, zbatohet vetëm në rastet kur rënia në vonesë për shlyerjen e detyrimit (dëmshpërblimit) bëhet me kërkesë të personave të dëmtuar. Tutje, Gjykata Supreme arsyetoi, se në rrethanat e rastit konkret nuk kemi të bëjmë me kërkesë për dëmshpërblim nga personi i dëmtuar, por me kërkesë për rënien në vonesë të shlyerjes së detyrimit nga kompania vendore e sigurimeve EUROSIG, ndaj parashtrueses së kërkesës, andaj në këtë kuptim Gjykata Supreme ka arsyetuar se perse paragrafi 6 i nenit 26 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia nuk zbatohet për parashtruesen e kërkesës por paragrafi 7 i nenit 26 i të njëjtit Ligj.

67. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës edhe më tutje mund të mos jetë e kënaqur me arsyetimin dhe bazën ligjore të zbatuar nga Gjykata Supreme. Megjithatë, në praktikën e saj gjyqësore në mënyrë konsistente Gjykata ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit bien brenda fushëveprimit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë antikushtetuese (shih, mes tjerash, Gjykata Kushtetuese rasti nr. KI33/16, parashtruese *Minire Zeka*, Aktgjykim i 4 gushtit 2018, paragrafi 91).

68. Duke i marrë parasysh elaboratet e cekura më sipër, Gjykata do të përdorë testin e vendosur në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së për të përcaktuar: (i) nëse ekzistojnë dallime "*të thella dhe afatgjata"* në praktikën gjyqësore të gjykatave vendase; (ii) nëse ligjet vendase sigurojnë një mekanizëm që mund të zgjidhë këto mospërputhje; (iii) nëse ai mekanizëm është zbatuar; dhe iv) nëse vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i përmbush kriteret e një

vendimi të arsyetuar në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës.

69. Gjykata i referohet përsëri Ligjit për Gjykatat nr. 06/L-054, i cili në nenin 14 parasheh mekanizmin për administrimin e duhur të drejtësisë dhe shqyrtimin e ndryshimeve në praktikën gjyqësore.

Neni 14
Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryetarit dhe nënkryetarit të Gjykatës

"[...]
Kryetari i gjykatës thërret takim vjetor të të gjithë gjyqtarëve për këshillim mbi Administrimin e Drejtësisë në atë gjykatë; për të analizuar organizimin e gjykatës; për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika."

70. Gjykata më tej thekson se në praktikën e saj gjyqësore në shumë raste ajo ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit janë brenda domenit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë antikushtetuese (shih, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI33/16, parashtruese *Minire Zeka*, Aktgjykim i 4 gushtit 2018, paragrafi 91).

71. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme është instanca e fundit dhe më e larta e gjyqësorit të rregullt dhe si e tillë duhet të kujdeset për harmonizimin e praktikës gjyqësore në Republikën e Kosovës, si dhe administrimin e duhur të drejtësisë. Është detyrim i Gjykatës Supreme që për rastet që janë relativisht të ngjashme, për aq sa është e mundur, vendimet e saj të jenë të parashikueshme dhe të karakterizohen nga korrektësia e rezultateve. Parashikueshmëria dhe rregullsia e vendimeve të Gjykatës Supreme do të ishin në të njëjtën mënyrë në favor të ankuesve dhe gjykatave më të ulëta.

72. Gjykata vëren se Gjykata Supreme konstatoi në Aktgjykimin e kontestuar: (i) se neni 324. 2 i LMD-së në lidhje me nenin 26.7 të Ligjit mbi Sigurimin e Autopërgjegjësisë janë dispozita ligjore që janë relevante për rastin e parashtruesit të kërkesës; (ii) që norma e interesit e "kualifikuar" prej 12% nuk zbatohet për rastet e regresit të borxhit, por vetëm për kërkesat për trajtimin e palëve të dëmtuara për dëmet në procedurat jashtë gjykatës; (iii) që interesi prej 12% të

zbatohet vetëm për zgjidhjen dhe vonesën në zgjidhjen e pretendimeve të palëve për kompensim të dëmit, dhe jo për regresin e borxhit; dhe (iv) që për këto arsye, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në kamatëvonesë "të thjeshtë" të paraparë në nenin 277 të LMD-së (kamata që paguhet për kursime me afat në një kohë më të gjatë se një vit pa destinim të caktuar) dhe jo kamatë të "kualifikuar" (12%).

73. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet pjesës përkatëse të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme e cila përcakton: *"...Paragrafi 7 i nenit 26 të Ligjit të lartpërmendur përjashton zbatimin e kamatës prej 12% edhe për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mos trajtimin dhe rënien në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar, për dëmshpërblim. Kështu që, pa dyshim rezulton se paditësi ka të drejtë vetëm në kamatën e thjeshtë, e jo edhe në kamatë "të kualifikuar" sipas dispozitave të cituara nga gjykata e shkallës së parë dhe të dytë. Meqë paditësja me parashtresën e datës 24.01.2012, ka kërkuar regresim të borxhit nga e paditura, rezulton se nga kjo datë e paditura ka rënë në vonesë në kuptim të nenit 324.2 të LMD të vjetër i cili atëherë ka qenë në fuqi, sipas të cilës: "Në qoftë se afati për përmbushje nuk është caktuar, debitori është në vonesë kur kreditori ta ftojë që ta plotësojë detyrimin e vet, verbalisht ose me shkrim, paralajmërim jashtëgjygësor, ose duke filluar ndonjë procedurë, qëllimi i së cilës është realizimi i përmbushjes të detyrimit". Nga kjo rezulton se paditësi në kuptim të nenit 277.1 të Ligjit të lartpërmendur ka të drejtë që ndaj debitorit-këtu të paditurës i cili është vonuar me përmbushjen e borxhit në të holla, të kërkojë përveç lartësisë së borxhit edhe kamatën e cila paguhet si për deponimet në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të përcaktuar, duke filluar nga dita e rënies së të paditurës në vonesë përkitazi me pagesën e borxhit kontestues. Përndryshe, sipas nenit 1057 të LMD të Republikës së Kosovës, dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Meqë dëmi ka ndodhur në kohën e vlefshmërisë së LMD të vjetër atëherë dispozitat e atij ligji zbatohen në përgjithësi, e në veçanti edhe për kamatën, nga se neni 1057 nuk përjashton nga zbatimi vetëm dispozitat për kamatën por tërë Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve të Republikës së Kosovës kur marrëdhëniet e detyrimeve kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, andaj në rastin konkret nuk mund të gjykohet asnjë lloj tjetër i kamatës përveç asaj të aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi".*

74. Çështja, nëse parashtruesit të kërkesës i është njohur e drejta për kamatëvonesë të "kualifikuar" (12%) ose për kamatë "të thjeshtë" e cila paguhet për mjetet e depozituara me një afat më të gjatë se një vit pa

destinim të caktuar, është çështje e aplikimit dhe interpretimit të ligjit nga Gjykata Supreme në gjykim, e cila, si e tillë, nuk është në vetvete në kundërshtim me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përveç nëse duket se ka shkelje flagrante të të drejtave dhe lirive themelore, gjë që nuk ka ndodhur në rastin i cili është në shqyrtim.

75. Bazuar në të cekurat më sipër, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme ka përcaktuar bazën ligjore dhe ka shpjeguar se në cilat raste zbatohet norma ligjore e cila përcakton kamatëvonesën e "kualifikuar" prej 12% përkatësisht kamatën "e thjeshtë" të paguar për kursimet e afatizuara për një periudhë më të gjatë se një vit pa destinim të caktuar dhe pse në rastin e parashtruesit të kërkesës zbatohet norma me të cilën përcaktohet kamatëvonesa "e thjeshtë" nga kamata e paguar për mjetet e afatizuara në kursime për një periudhë më të gjatë se një vit pa destinim të caktuar. Në Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, ekziston një lidhje logjike midis bazës ligjore, arsyetimit dhe përfundimeve të nxjerra, që do të thotë se Aktgjykimi i kontestuar i përmban të gjithë komponentët e një vendimi të arsyetuar.

76. Për sa i përket konsistencës së praktikës gjyqësore, në bazë të testit të trefishtë të vendosur nga GJEDNJ, Gjykata konstaton: (i) se në rastin në shqyrtim nuk është vërtetuar se ekzistojnë dallime "*të thella dhe afatgjata*" përkitazi me konsistencën e praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme; (ii) që ekziston mekanizmi për administrimin e duhur të drejtësisë dhe shqyrtimin e dallimeve në praktikën gjyqësore (shih Ligjin për Gjykatat Nr. 06/L-054, neni 14. 2.10); dhe (iii) që Gjykata Supreme, më 1 dhjetor 2020, lëshoi "Mendimin Juridik mbi kamatën, në lidhje me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes" në bazë të nenit 14. 2.10 të Ligjit për Gjykatat.

77. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së nuk përcakton të drejtën e fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore. Në vetvete, zhvillimi i praktikës gjyqësore nuk është në kundërshtim me administrimin e duhur të drejtësisë pasi dështimi për të mbajtur një qasje dinamike dhe evolutive do të rrezikonte parandalimin e reformës ose frustrimin e përmirësimit (shih rastet e GJEDNJ-së *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, Aktgjykim i 20 tetorit 2010, paragrafi 58; *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë* (Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 116). Dallimet në praktikë gjyqësore, nga vetë natyra e tyre, janë pasojë e qenësishme e çdo sistemi gjyqësor të bazuar në një rrjet të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit të autorizuara për të gjykuar në juridiksionin e tyre

territorial. Roli i Gjykatës Supreme pasqyrohet saktësisht në zgjidhjen e konflikteve të tilla (shih GJEDNJ *Beian kundër Rumanisë* (nr. 1), cituar më lart, paragrafi 37).

78. Sa i përket vendimeve të Gjykatës Supreme të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës për të ilustruar pikëpamjet kontradiktore të Gjykatës Supreme dhe për t'i krahasuar ato me Aktgjykimin e kontestuar në rastin i cili është në shqyrtim, Gjykata thekson se nuk është funksioni i saj t'i krahasojë ato vendime me Aktgjykimin e kontestuar, me përjashtim të rasteve të arbitraritetit të dukshëm që nuk ndodhi në rrethanat e rastit konkret, veçanërisht në lidhje me respektimin e pavarësisë së gjykatave të rregullta (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ *Adamsons kundër Letonisë*, cituar më lart, paragrafi 118).

79. Në bazë të të cekurave më lart, Gjykata konkludon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është në pajtim me të drejtën në siguri juridike dhe për një vendim të arsyetuar: (i) shpjegon se kamatëvonesa e "kualifikuar" prej 12% vlen vetëm për moszgjidhjen apo vonesën për të zgjidhur pretendimet e palëve të dëmtuara për kompensim të dëmit, jo për regresim të borxhit; (ii) që parashtruesi i kërkesës, në bazë të nenit 277.1 të LMD-së së vjetër, ka të drejtë të kërkojë nga debitori, i cili është vonuar me përmbushjen e borxhit në të holla, përveç shumës së borxhit edhe shumën e kamatëvonesës "së thjeshtë" që paguhet për kursimet e afatizuara për një periudhë më të gjatë se një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita kur e paditura filloi të vonohej për sa i përket pagesës së borxhit të kontestuar; dhe (iii) se Gjykata Supreme, më 1 dhjetor 2020, lëshoi një "Mendim Juridik për kamatën sa i përket ligjit të aplikueshëm, lartësisë dhe periudhës së llogaritjes" në bazë të nenit 14.2.10 të Ligjit për Gjykatat.

80. Prandaj, Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përfundim

81. Në lidhje me pretendimet për shkelje të parimit të sigurisë juridike, Gjykata konstatoi: (i) se në rastin konkret nuk ishte vërtetuar ekzistenca e dallimeve "të thella dhe afatgjata" përkitazi me konsistencën e praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme; (ii) se ekziston mekanizmi për administrimin e duhur të drejtësisë dhe për shqyrtimin e dallimeve në praktikën gjyqësore (shih Ligjin për Gjykatat nr. 06/L-054, neni 14. 2.10); (iii) se Gjykata Supreme, më 1 dhjetor 2020, lëshoi një "Mendim Juridik për kamatën sa i përket ligjit

të aplikueshëm, lartësisë dhe periudhës së llogaritjes" në bazë të nenit 14.2.10 të Ligjit për Gjykatat; (iv) që mundësia e vendimeve kontradiktore është një tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor të bazuar në një rrjet të gjykatave themelore dhe të apelit me autorizime brenda juridiksionit të saj territorial; (v) dhe se cili ligj duhet të aplikohet në rrethanat e rastit konkret është prerogativë dhe detyrë e Gjykatës Supreme; dhe (vi) se roli i Gjykatës Supreme është pikërisht të zgjidhë konflikte të tilla.

82. Në lidhje me pretendimet për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, Gjykata konstatoi se: (i) Gjykata Supreme deklaroi bazën ligjore dhe shpjegoi pse në rastin e parashtruesit të kërkesës aplikohet norma e cila përcakton kamatëvonesën "e thjeshtë" që paguhet për mjetet e kursimeve të afatizuara për një periudhë më të gjatë se një vit pa destinim të caktuar; (ii) që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmban lidhjen logjike midis bazës ligjore, arsyetimit dhe konkluzioneve të nxjerra; (iii) që, si një rrjedhë logjike midis bazës ligjore, arsyetimit dhe konkluzioneve, rezultoi që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme plotëson kriterin e një vendimi të arsyetuar; dhe (iv) çështja nëse parashtruesit të kërkesës i është njohur e drejta për kamatëvonesë të "kualifikuar" prej 12% ose për kamatë "të thjeshtë" e cila paguhet për mjetet e depozituara me një afat më të gjatë se një vit pa destinim të caktuar, është çështje e aplikimit dhe interpretimit të ligjit dhe diskrecionit të Gjykatës Supreme në gjykim, e cila, si e tillë, nuk është në vetvete në kundërshtim me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

83. Në fund, Gjykata konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 prill 2021

VENDOS

I. TË DEKLAROJË njëzëri kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, E. Rev. nr. 39/2018, i 8 janarit 2019, është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve, dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit ta publikojë të njëjtin në Gazetën Zyrtare;

IV. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

KO88/21, Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës, Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

KO88/21, Aktvendim për papranueshmëri i publikuar me 19.07.2021

Në seancën shqyrtuese të mbajtur më 2 korrik 2021, Gjykata shqyrtoi rastin KO88/21, përkatësisht kërkesën e Presidentes së Republikës së Kosovës për (i) "*interpretimin e nocionit "grupi më i madh parlamentar" në kontekst të ndarjes së vendeve në KQZ për grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në kuptim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;* dhe (ii) *"për zgjidhje të konfliktit të autorizimeve të grupeve parlamentare për të propozuar anëtarët e KQZ-së*".

Gjykata vëren se bazuar në faktet e këtij rasti, rezulton se (i) më 22 prill 2021, Presidentja e Republikës kishte dërguar kërkesë tek grupet parlamentare për nominimin e kandidatëve për anëtarë të KQZ-së; dhe (ii) në mes të datave 29 prill 2021 dhe 12 maj 2021, grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilat nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të garantuara, përkatësisht LVV, PDK, LDK dhe AAK, kishin propozuar anëtarët përkatës, ndërsa subjektet politike të cilat mbajnë vende të garantuara për komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë, gjithashtu kishin dorëzuar nominimet e tyre.

Presidentja e Republikës së Kosovës, më 12 maj 2021, ka emëruar tetë (8) anëtarë të KQZ-së. Dy (2) anëtarët e tjerë nuk janë emëruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, sepse (i) LVV ka propozuar tre (3) kandidatë për anëtarë të KQZ-së, ndërsa PDK ka propozuar dy (2) kandidatë për anëtarë të KQZ-së, dhe duke pretenduar "*paqartësi*" në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës që përcakton se "*nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë*", Presidentja e Republikës së Kosovës i është drejtuar Gjykatës me kërkesën për interpretim të "*grupit më të madh parlamentar*" në kontekst të dispozitës së lartcekur, përkatësisht nëse vendet e lira në KQZ i takojnë vetëm *grupit* apo *grupeve* më të mëdha parlamentare; dhe (ii) komuniteti boshnjak, në strukturën aktuale të Kuvendit, është i përfaqësuar përmes tri (3) subjekteve të ndryshme politike me numër të barabartë të ulëseve në Kuvend, ndërsa në Presidencë janë dorëzuar tri (3) propozime nga ky komunitet, ndonëse të njëjtit i takon vetëm një (1) vend në KQZ. Rrjedhimisht, Presidentja e Republikës gjithashtu pretendon "*paqartësi*" në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, përkitazi me emërimin e anëtarëve të KQZ-së nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë, në rastet kur një komunitet përfaqësohet nga më shumë subjekte politike, por me numër të barabartë ulësesh në Kuvend.

Në kontekst të rrethanave të lartcekura dhe duke theksuar se "*paqartësia e kompetencave po i pamundëson Presidentes që ti emërojë të gjithë anëtarët e KQZ-së, si organ i cili i administron dhe menaxhon zgjedhjet e lira, të barabarta dhe të drejtpërdrejta në Kosovë*", Presidentja e Republikës së Kosovës i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me (i) kërkesën për interpretimin e nocionit të "*grupit më të madh parlamentar*" në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, duke u bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës; dhe (ii) kërkesën për zgjidhjen e konfliktit të "*autorizimeve*" të grupeve parlamentare për të propozuar anëtarët e KQZ-së, duke u bazuar në pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës.

(i) Përkitazi me vlerësimin e pranueshmërisë në kontekst të paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës

Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës së Presidentes për interpretim të paqartësive kushtetuese bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës dhe kërkesën përkatëse për përgjigjen në katër (4) pyetje të parashtruara para Gjykatës dhe të cilat do të reflektohen në tërësi në Aktvendimin për Papranueshmëri që do të publikohet në përputhje me rregullat procedurale në ditët në vijim, Gjykata konstatoi që kërkesa e Presidentes është e papranueshme. Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore, duke përfshirë rastin KO79/18, në të cilin gjithashtu është trajtuar një kërkesë e Presidentit të Republikës për interpretimin e paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, ka qartësuar që (i) paragrafi 9 i nenit 84 të Kushtetutës nuk është i pavarur nga neni 113 i Kushtetutës; (ii) paragrafi 9 i nenit 84 dhe paragrafi 1 i nenit 112 të Kushtetutës nuk mund të interpretohen jashtë kontekstit të nenit 113 të Kushtetutës; dhe (iii) bazuar në nenin 113 të Kushtetutës, Gjykatës i është kufizuar mundësia që të marrë rol konsultativ apo këshillëdhënës përmes përgjigjes në pyetje të parashtruara para saj, ngase ky rol do të binte ndesh me rolin e saj themelor për vendosjen e rasteve të ngritura para saj.

(ii) Përkitazi me vlerësimin e pranueshmërisë në kontekst të pikës (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës

Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës së Presidentes, bazuar në pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës, përkitazi me zgjidhjen e konfliktit të "*autorizimeve*" në mes të "*kompetencës kushtetuese*" të Presidentes dhe "*kompetencës së grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvend*" për nominimin e anëtarëve të KQZ-së, Gjykata fillimisht theksoi se neni i lartcekur i Kushtetutës përcakton që Presidenti i Republikës së Kosovës është një nga tri palët e autorizuara që të ngre çështje të "*konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës*". Kjo dispozitë është interpretuar nga Gjykata përmes Aktvendimeve në rastet KO131/18 dhe KO181/18, duke sqaruar tri kriteret kumulative kushtetuese të cilat duhet të plotësohen në

mënyrë që kërkesat e ngritura në bazë të këtij neni të kalojnë testin e pranueshmërisë. Në rastet e lartcekura, Gjykata kishte sqaruar se në kuptim të nenit 113.3.(1) të Kushtetutës, duhet të plotësohen tri kriteret në vijim: (i) konflikti të ngritët nga njëra nga tri palët e autorizuara; (ii) konflikti të ngritët për "*kompetenca kushtetuese*" të Kuvendit, Presidentit dhe/ose Qeverisë së Republikës së Kosovës; dhe që (iii) të ketë një konflikt.

Gjykata vlerësoi se në rrethanat e këtij rasti është plotësuar kriteri i parë kushtetues, sepse kërkesa është dorëzuar në Gjykatë nga Presidentja e Republikës së Kosovës, si njëra nga tri palët e autorizuara. Megjithatë, Gjykata konstatoi se kriteri i dytë kushtetues në kontekst të nenit 113.3.(1) të Kushtetutës, nuk është plotësuar, sepse siç ka sqaruar Gjykata në rastet KO131/18 dhe KO181/18, konflikti i supozuar duhet të burojë nga kompetencat kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë për palët e autorizuara. Në rrethanat e rastit konkret, për dallim nga nenet 84 (26), 139 (3) dhe 139 (4) të Kushtetutës, e të cilat përcaktojnë kompetencën kushtetuese të Presidentes për emërimin e Kryesuesit të KQZ-së dhe mënyrën e emërimit të anëtarëve të këtij të fundit, kompetenca e Presidentes për emërimin e anëtarëve të KQZ-së nuk është e përcaktuar me Kushtetutë, por vetëm me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht me pikën (a) të paragrafit 3 të nenit 61 të tij.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Gjykatës, në rrethanat e rastit konkret, Presidentja e Republikës nuk ka ngritur para Gjykatës konflikt të "*kompetencave kushtetuese*", sipas përcaktimeve të nenit 113.3.(1) të Kushtetutës, dhe për pasojë, Gjykata shpalli kërkesën e Presidentes së Republikës së Kosovës të papranueshme bazuar në nenin 113 të Kushtetutës dhe refuzoi kërkesën për caktim të masës së përkohshme bazuar në nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO88/21

Parashtrues

Presidentja e Republikës së Kosovës

Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesja e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj, Vjosa Osmani-Sadriu (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Parashtruesja e kërkesës kërkon: (i) interpretimin e nocionit "grupi më i madh parlamentar" në kontekst të ndarjes së vendeve në Komision Qendror Zgjedhor (në tekstin e mëtejmë: KQZ) për grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi), në kuptim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); dhe (ii) zgjidhje të konfliktit të autorizimeve të grupeve parlamentare për të propozuar anëtarët e KQZ-së.

3. Në kontekst të paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës, kërkesa e parashtrueses së kërkesës është paraqitur në formë të katër (4) pyetjeve që mund të përmblidhet si vijon: (i) cili është kuptimi i

nocionit të grupit apo grupeve parlamentare në ndërlidhje me fjalën "mund" të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës; (ii) cili është kriteri mbizotërues për të vendosur nëse dy (2) anëtarët shtesë të KQZ-së duhet të emërohen nga grupi më i madh parlamentar apo nga disa grupe parlamentare, sidomos kur një grup parlamentar ka fituar mbi 50% të votave në zgjedhje; (iii) nëse duhet të reflektohet parimi i proporcionalitetit (numri i deputetëve të një grupi parlamentar në raport me të tjerat) për të vendosur nëse dy (2) anëtarët shtesë në KQZ i takojnë vetëm një grupi apo disa grupeve parlamentare; dhe, (iv) në rastet kur komunitetet jo shumicë kanë numër të njëjtë të deputetëve, si përcaktohet radha e tyre në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës?

4. Parashtruesja e kërkesës po ashtu kërkon caktim të masës së përkohshme duke arsyetuar: *"[p]ër shkak të rrethanave specifike të shpjeguara në këtë kërkesë, dhe me qëllim të ruajtjes së sigurisë juridike dhe interesit publik, kërkohet vendosja e masës së përkohshme në zbatimin e afateve ligjore (60 ditë nga ditë e certifikimit të rezultatit zgjedhor) , siç parashihet në nenin 61, paragrafin 4, të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me fillimin e mandatit të dy anëtarëve të KQZ-së, të cilët nuk janë emëruar në këtë raund për shkak të paqartësive kushtetuese. Nevoja për masë të përkohshme për rrjedhjen e afateve bëhet sidomos relevante për faktin se brenda këtij viti do të organizohen zgjedhjet lokale, dhe është e domosdoshme që veprimet të cilat ndërmerren nga Presidentja në lidhje me emërimin e anëtarëve të KQZ-së të jenë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës."*

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 9 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës dhe nën paragrafin (1) të paragrafit 3 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si në nenin 31 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenin 27 [Masat e Përkohshme] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe rregullin 68 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës dhe me nenet 31 dhe 32 të Ligjit] dhe rregullin 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 maj 2021, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 14 maj 2021, parashtruesja e kërkesës, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kryetarja e KQZ-së u njoftuan për regjistrim të kërkesës. Nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës u kërkua që nga një kopje të kërkesës t'ua dorëzojë të gjithë deputetëve dhe grupeve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me qëllim që t'i dorëzojnë komentet e tyre me shkrim, nëse kanë, deri më 31 maj 2021.

8. Më 17 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

9. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

10. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

11. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama–Hajrizi, përmes Vendimit Nr. KO88/21, caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi si Gjyqtar raportues në vend të Gjyqtarit Bekim Sejdiu pas dorëheqjes së tij.

12. Grupet parlamentare, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës por as Palët tjera të njoftuara, nuk dorëzuan komente lidhur me këtë kërkesë, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata.

13. Më 24 qershor 2021, Kryetari i Kuvendit iu drejtua Gjykatës me kërkesë për shtyrje të afatit për dorëzim të komenteve nga Deputetët e Kuvendit të Kosovës duke shpjeguar se shkresa e 14 majit 2021 nuk u ishte dërguar Deputetëve të Kuvendit për arsye objektive.

14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

15. Më 28 qershor 2021, Gjykata njoftoi Kryetarin e Kuvendit të Kosovës se kërkesa për shtyrje të afatit për dorëzim të komenteve nga Deputetët e Kuvendit është paraqitur tri javë pas përmbylljes së afatit për dorëzim të komenteve dhe se e njëjta refuzohet bazuar në paragrafin 3 të rregullin 33 të Rregullores së punës. Gjykata në praktikën gjyqësore të saj ka refuzuar kërkesat për shtyrje të afatit për dorëzim të komenteve (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KO61/20 *parashtrues: Uran Ismaili dhe 29 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 1 majit 2020, paragrafi 23; dhe KO98/20 *parashtrues: Hajrulla Çeku dhe 29 deputetë,* Vendim për Heqje të Kërkesës nga Lista, i 18 nëntorit 2020, paragrafi 19).

16. Më 2 korrik 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe, njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata votoi, me shumicë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

17. Më 14 shkurt 2021, janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

18. Më 12 mars 2021, KQZ-ja certifikoi rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve: Lëvizja Vetëvendosje 50.280% (58 ulëse), PDK 17.009% (19 ulëse), LDK 12.731% (15 ulëse), SL 5.094% (10 ulëse), AAK 7.124% (8 ulëse), KDTP 0.745% (2 ulëse), Vakat 0.616% (1 ulëse), IRDK 0.379% (1 ulëse), RI 0.364% (1 ulëse), NDS 0.331% (1 ulëse), SDU 0.292% (1 ulëse), JGP 0.248% (1 ulëse), PAI 0.245% (1 ulëse) dhe LPRK 0.139% (1 ulëse).

19. Më 22 prill 2021, Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës kishte dërguar kërkesë tek grupet parlamentare për nominimin e kandidatëve për anëtarë të KQZ-së, të cilët më pas do të dekretoheshin nga Presidentja.

20. Më 29 prill 2021, subjekti politik AAK, si grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvend, i cili nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ndarjen

e vendeve të rezervuara, ka nominuar një (1) anëtar nga ky subjekt politik në KQZ.

21. Më 5 maj 2021, subjekti politik SDU, që përfaqëson komunitetin boshnjak me një (1) deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka dërguar në ZPRK propozimin për anëtar të KQZ-së.

22. Më 5 maj 2021, subjekti politik LS, që përfaqëson komunitetin serb me dhjetë (10) deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka dërguar në ZPRK propozimin për anëtar në KQZ.

23. Më 6 maj 2021, subjekti politik IRDK, që përfaqëson komunitetin egjiptian me një (1) deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka dërguar në ZRPK propozimin për anëtar në KQZ.

24. Më 6 maj 2021, "Koalicija VAKAT", që përfaqëson komunitetin boshnjak me një (1) deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka dërguar propozimin për anëtar në KQZ.

25. Më 6 maj 2021, subjekti politik LDK, si grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili nuk ka të drejtë të merr pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara, ka nominuar një (1) anëtar nga ky subjekt politik si përfaqësues në KQZ.

26. Më 7 maj 2021, subjekti politik NDS, që përfaqëson komunitetin boshnjak me një (1) deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka dërguar në ZPRK propozimin për anëtar në KQZ.

27. Më 7 maj 2021, subjekti politik PDK, si grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvend, i cili nuk ka të drejtë të merr pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara, ka nominuar dy (2) anëtarë nga ky subjekt politik si përfaqësues në KQZ.

28. Më 11 maj 2021, subjekti politik KDTP, që përfaqëson komunitetin turk me dy (2) deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka dërguar në ZPRK propozimin për një (1) anëtar në KQZ.

29. Më 12 maj 2021, Lëvizja Vetëvendosje, si grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili nuk ka të drejtë të merr pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara, ka nominuar tre (3) anëtarë nga ky subjekt politik si përfaqësues në KQZ.

30. Më 12 maj 2021, Presidentja e Republikës së Kosovës emëroi tetë (8) anëtarë të KQZ-së. Presidentja e Republikës së Kosovës nuk i emëroi dy (2) anëtarë tjerë të KQZ-së për shkak të "paqartësisë" në kontekst

të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, duke iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Kërkesa e parashtrueses së kërkesës

31. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës kërkon interpretimin e nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] paragrafi 4, të Kushtetutës. Gjykata rithekson se kërkesa për interpretim e Parashtrueses së kërkesës është paraqitur në formë të katër (4) pyetjeve që mund të përmblidhet si vijon: (i) cili është kuptimi i nocionit të grupit apo grupeve parlamentare në ndërlidhje me fjalën "mund" të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës; (ii) cili është kriteri mbizotërues për të vendosur nëse dy (2) anëtarët shtesë të KQZ-së duhet të emërohen nga grupi më i madh parlamentar apo nga disa grupe parlamentare, sidomos kur një grup parlamentar ka fituar mbi 50% të votave në zgjedhje; (iii) nëse duhet të reflektohet parimi i proporcionalitetit (numri i deputetëve të një grupi parlamentar në raport me të tjerat) për të vendosur nëse dy (2) anëtarët shtesë në KQZ i takojnë vetëm një grupi apo disa grupeve parlamentare; dhe, (iv) në rastet kur komunitetet jo shumicë kanë numër të njëjtë të deputetëve, si përcaktohet radha e tyre në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës?

Përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës

(iii) Përkitazi me pikën (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës

32. Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës bazuar në pikën (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës fillimisht thekson se ajo është e autorizuar të ngre çështje që ndërlidhen me konfliktin e kompetencave ndërinstitucionale. Lidhur me këtë ajo thekson se *"Kuvendi i Republikës se Kosovës përbehet nga 120 deputete. Këta deputetet për të funksionalizuar punën e Kuvendit të Republikës se Kosovës, formojnë grupe parlamentare të cilat ushtrojnë funksionin e tyre brenda ombrellës së Kuvendit. Rrjedhimisht, grupet parlamentare janë trupa përbërëse të Kuvendit të Republikës së Kosovës. E drejta për nominim të anëtarëve të KQZ-së është kompetencë e grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, sipas përcaktimit nga Neni 139, paragrafi 4, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës."* Sipas parashtrueses së kërkesës *"grupet parlamentare të VV-së dhe PDK-së, kanë propozuar kandidatët e tyre për anëtarë në KQZ, por numri i të propozuarve nuk përkon me numrin e ulëseve të lira për anëtarët e këtyre dy grupeve parlamentare."*

33. Andaj, ajo pretendon se në rastin në fjalë, *"kemi të bëjmë me konfliktit të autorizimeve të grupeve parlamentare (si organe të Kuvendit) për të propozuar kandidatët për anëtarë të KQZ-së, si hap fillestar para emërimit nga ana e Presidentes, si kompetencë kushtetuese e Presidentes. Në këtë rast, si kompetenca e grupeve parlamentare për të propozuar, ashtu edhe kompetenca e Presidentes për të emëruar, janë të parapara në Nenin 139 të Kushtetutës së Kosovës. Rrjedhimisht, që të dyja janë kompetenca kushtetuese."*

34. Parashtruesja e kërkesës më tej thekson se në rastin KO131/18, Gjykata kishte përcaktuar tri kritere që duhen plotësuar në mënyrë që rasti të konsiderohet i pranueshëm në përputhje me nenin 113, paragrafi 3, nën-paragrafi 1 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, dhe atë që konflikti i kompetencave të: (i) ngrehet nga njëra nga tri palët e autorizuara; (ii) që konflikti të ngrehet për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuara; dhe, (iii) që të ketë konflikt.

35. Rrjedhimisht, parashtruesja e kërkesës thekson se në rastin konkret përmbushen tri kërkesat e ngërthyera në nenin 113 paragrafi 3, nën-paragrafi 1 të Kushtetutës të zbërthyera nga Gjykata në rastin nr. KO131/18 sepse: (i) konflikti ngrehet nga njëra prej tri palëve të autorizuara e që është Presidentja e Republikës së Kosovës; (ii) konflikti ngrehet për një kompetencë kushtetuese të caktuar, në këtë rast për nominimin dhe emërimin e anëtarëve të KQZ-së siç parashihet në nenin 139, paragrafi 4 i Kushtetutës; (iii) konflikti ekziston meqë nominimi për anëtarë në KQZ , e cila është kompetencë e grupeve parlamentare si trupa të Kuvendit, i paraprinë emërimit të anëtarëve të KQZ-së, si kompetencë e Presidentes së Republikë së Kosovës; dhe, rrjedhimisht, (iv) rasti në fjalë përmbush tri kriteret e përcaktuara nga Gjykata.

(iv) Përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës sipas paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës

36. Në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës bazuar në nenin 84 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës pohon se: (i) *"sipas Nenit 84, paragrafi 2, të Kushtetutës, një ndër kompetencat e Presidentes është edhe garantimi për "funksionimin Kushtetues të institucioneve [...]";* (ii) Kushtetuta i jep të drejtë Presidentes që të kërkojë interpretim të çështjeve kushtetuese kur kemi të bëjmë me paqartësi rreth frymës së Kushtetutës dhe kjo mbështetet edhe me faktin se e drejta për të referuar çështje kushtetuese, është vendosur nën "ombrellën" e kompetencave të Presidentes bazuar në nenin 84 të Kushtetutës; (iii) kërkesa bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës nuk

kufizohet në kërkesa tjera dhe sugjeron për një interpretim të gjerë të kuptimit të çështjeve kushtetuese.

37. Në këtë kontekst, parashtruesja e kërkesës pretendon se: (i) ndarja e numrit të propozimeve të emërimeve të anëtarëve në KQZ nuk rregullohet me ndonjë akt tjetër përveçse me Kushtetutë, çka vërteton se kërkesa është "çështje e pastër kushtetuese"; (ii) praktika e Gjykatës tregon se nocioni "çështje kushtetuese" mund të aplikohet në kuptim të zgjeruar (iii) kuptimi i zgjeruar i nocionit "çështje kushtetuese" është adekuat për t'u aplikuar në këtë kërkesë sepse çështjet e ngritura nuk janë vlerësuar më parë nga kjo Gjykatë apo ndonjë gjykatë tjetër; (iv) çështjet kushtetuese mund të pranohen nga Gjykata edhe kur nuk lidhen me juridiksionin e përcaktuar me nenin 113 paragrafët 1 dhe 2 por edhe me nenin 112 paragrafi 1 dhe për këtë, mes tjerash, citon rastet e Gjykatës nr. KO80/10; KO97/10; KO57/12; KO103/14; dhe KO130/15; dhe, se (v) kjo kërkesë buron nga neni 84 paragrafi 9 i Kushtetutës që parashikon referimin e çështjeve kushtetuese në Gjykatë si një nga funksionet e Presidentes.

38. Andaj, parashtruesja e kërkesës pretendon se *"kjo kërkesë përmbush kriteret e kërkuara për pranueshmëri të saj edhe në bazë të Nenit 84 [të Kushtetutës]. Së pari, i referohet autoritetit kompetent dhe përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës. Së dyti, kërkesa buron nga Neni 84, paragrafi 9 i Kushtetutës me të cilin parashihet referimi çështjeve kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese si një nga funksionet e Presidentes."*

Përkitazi me meritat e kërkesës

39. Lidhur me meritat e kërkesës parashtruesja e kërkesës pretendon se: "*Neni 139 paragrafi 4 i Kushtetutës parasheh se nga cilat grupe parlamentare duhet të propozohen anëtarët në rastin kur janë gjashtë grupe parlamentare të cilat nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Ky nen vazhdon edhe në situatën kur kemi më pak se gjashtë grupe parlamentare por nuk përcakton shprehimisht se cilit grup i takojnë anëtarët shtesë. Thënë këtë, fjalia e dytë e Nenit 139, paragrafi 4, i Kushtetutës tregon se "grupi" a "grupet" më të mëdha "mund" të emërojnë anëtarë shtesë.*"

40. Parashtruesja e kërkesës pohon se interpretimi i pyetjeve kushtetuese do të shërbente si referencë edhe për proceset e ardhshme të emërimit të anëtarëve të KQZ-së, së paku për dy arsye: (i) do të saktësonte formulën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së, duke specifikuar kriteret mbizotëruese për emërim të anëtarëve nga "grupi" apo "grupet" më të mëdha në rast se në Kuvend përfaqësohen më pak 6 grupe

parlamentare, dhe, (ii) do ta saktësonte formulën në bazë të cilës do të emërohen anëtarët jo shumicë, në rast kur një komunitet i caktuar është i përfaqësuar në Kuvend me numër të barabartë të deputetëve nga subjekte të ndryshme politike.

41. Parashtruesja e kërkesës pohon se interpretimi i Gjykatës Kushtetuese do të ofronte siguri juridike në ndërmarrjen e veprimeve të Presidentes për emërimin e anëtarëve të KQZ-së, si dhe njëkohësisht do të ishte në interesin publik duke mundësuar funksionalizim të plotë e pa vonesa të një institucioni të rëndësishëm sikurse KQZ-ja, sidomos duke pasur parasysh faktin se shumë shpejt KQZ pritet të filloj punën lidhur me administrimin e zgjedhjeve lokale.

Përkitazi me caktimin e masës së përkohshme

42. Në lidhje me kërkesën për caktim të masës së përkohshme, parashtruesja e kërkesës thekson: (i) kërkohet vendosja e masës së përkohshme në zbatimin e afateve ligjore (60 ditë nga dita e certifikimit të rezultatit zgjedhor), siç parashikohet me nenin 61, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me fillimin e mandatit të dy anëtarëve të KQZ-së, të cilët nuk janë emëruar në këtë raund për shkak të paqartësive kushtetuese; dhe, se (ii) nevoja për masë të përkohshme për rrjedhjen e afateve bëhet sidomos relevante për faktin se brenda këtij viti do të organizohen zgjedhjet lokale, dhe është e domosdoshme që veprimet që ndërmerren nga Presidentja në lidhje me emërimin e anëtarëve të KQZ-së të jenë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 84
[Kompetencat e Presidentit]

[...]

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;

(26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

[...]

Neni 112
[Parimet e Përgjithshme]

1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

[...]

Neni 113
[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

1.Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

2.Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) Çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;

(2) Përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:

(1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kushtetutës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

(2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;

(3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;

(4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;

(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.

Neni 139
[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

[...]

3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me jurisdiksion apeli.

4. Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.

Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (publikuar në Gazetën Zyrtare më 15 qershor 2008)

Neni 61
Mandati dhe Emërimi i Anëtarëve të KQZ-së

61.1 Kryesuesi i KQZ-së emërohet në pajtueshmëri me nenin 139.3 të Kushtetutës së Kosovës.

61.2 Mandati i Kryetarit të KQZ-së është shtatë (7) vjet duke filluar nga data e caktuar për njoftim të emërimit nga Presidenti i Kosovës.

61.3 Neni 139.4 i Kushtetutës së Kosovës parasheh se caktimi i anëtarëve të KQZ-së duhet të bëhet sipas procedurave në vijim:

a) Brenda dhjetë (10) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, grupet parlamentare me të drejtë të caktimit të anëtarit(ve) në KQZ e njoftojnë Presidentin e Kosovës për nominimin e tyre. Pas sigurimit se individi i caktuar nga grupi parlamentar i përshtatet kërkesave të këtij ligji, Presidenti i Kosovës, brenda pesë (5) ditëve e konfirmon me shkrim emërimin. Emërimi hyn në fuqi në ditën e shënuar në Emërimin zyrtar nga Presidenti i Kosovës;

b) Kryesuesi i KQZ-së nuk shërben në më shumë se dy (2) mandate të njëpasnjëshme;
c) Anëtarët e KQZ-së nuk shërbejnë në më shumë se tri (3) mandate të njëpasnjëshme;
d) Përfundimi i mandatit bëhet në ditën e fundit të muajit kalendarik, në të njëjtin muaj në të cilin ka filluar mandati;

e) Pavarësisht nga pika (d) e këtij paragrafi mandati që përfundon nëntëdhjetë (90) ditë ose më pak para zgjedhjeve ose deri 90 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, automatikisht zgjatet për 90 ditë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore.

61.4 Mandati i anëtarëve të KQZ-së fillon jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend.

Pranueshmëria e kërkesës

43. Në mënyrë që të vendosë lidhur me kërkesën e parashtrueses së kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kriteret e pranueshmërisë, sikurse që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe saktësuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

44. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës ku edhe përcaktohet juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për të vendosur lidhur me rastet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës, përkatësisht Presidentja.

45. Në bazë të nenit 113, paragrafi 2, të Kushtetutës, "*[...] Presidenti i Republikës së Kosovës [...][është i] autorizuar të ngrejë rastet në vijim*:
(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të [...] Kryeministrit, dhe të rregulloreve të qeverisë, me Kushtetutën;

(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës më Kushtetutën.

46. Më tej, neni 113, paragrafi 3, i Kushtetutës, përcakton që *[...], Presidenti i Republikës së Kosovës [...][është i] autorizuar të ngrejë çështjet në vijim:*
(1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

(2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;
(3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;
(4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;
(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.

47. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit (9) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], të ndërlidhur me dispozitat e lartcekura, i cili përcakton:

"Presidenti i Republikës së Kosovës:
[...]

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
[...]

48. Lidhur me këtë Gjykata fillimisht vëren se bazuar në faktet e këtij rasti, rezulton se (i) më 22 prill 2021, Presidentja e Republikës kishte dërguar kërkesë tek grupet parlamentare për nominimin e kandidatëve për anëtarë të KQZ-së; dhe (ii) në mes të datave 29 prill 2021 dhe 12 maj 2021, grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilat nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të garantuara, përkatësisht LVV, PDK, LDK dhe AAK, kishin propozuar anëtarët përkatës, ndërsa subjektet politike të cilat mbajnë vende të garantuara për komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë, gjithashtu kishin dorëzuar nominimet e tyre.

49. Presidentja e Republikës së Kosovës, më 12 maj 2021, ka emëruar tetë (8) anëtarë të KQZ-së. Dy (2) anëtarët e tjerë nuk janë emëruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, sepse (i) LVV ka propozuar tre (3) kandidatë për anëtarë të KQZ-së, ndërsa PDK ka propozuar dy (2) kandidatë për anëtarë të KQZ-së, dhe duke pretenduar "*paqartësi*" në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës që përcakton se "*nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë*", Presidentja e Republikës së Kosovës i është drejtuar Gjykatës me kërkesën për interpretim të "*grupit më të madh parlamentar*" në kontekst të dispozitës së lartcekur, përkatësisht nëse vendet e lira në KQZ i takojnë vetëm *grupit* apo *grupeve* më të mëdha parlamentare; dhe (ii) komuniteti boshnjak, në strukturën aktuale të Kuvendit, është i

përfaqësuar përmes tri (3) subjekteve të ndryshme politike me numër të barabartë të ulëseve në Kuvend, ndërsa në Presidencë janë dorëzuar tri (3) propozime nga ky komunitet, ndonëse të njëjtit i takon vetëm një (1) vend në KQZ. Rrjedhimisht, Presidentja e Republikës gjithashtu pretendon "*paqartësi*" në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, përkitazi me emërimin e anëtarëve të KQZ-së nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë, në rastet kur një komunitet përfaqësohet nga më shumë subjekte politike, por me numër të barabartë ulësesh në Kuvend.

50. Gjykata rithekson se kërkesa për interpretim e Presidentes është paraqitur në formë të katër (4) pyetjeve që mund të përmblidhet si vijon: (i) cili është kuptimi i nocionit të grupit apo grupeve parlamentare në ndërlidhje me fjalën "mund" të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës; (ii) cili është kriteri mbizotërues për të vendosur nëse dy (2) anëtarët shtesë të KQZ-së duhet të emërohen nga grupi më i madh parlamentar apo nga disa grupe parlamentare, sidomos kur një grup parlamentar ka fituar mbi 50% të votave në zgjedhje; (iii) nëse duhet të reflektohet parimi i proporcionalitetit (numri i deputetëve të një grupi parlamentar në raport me të tjerat) për të vendosur nëse dy (2) anëtarët shtesë në KQZ i takojnë vetëm një grupi apo disa grupeve parlamentare; dhe, (iv) në rastet kur komunitetet jo shumicë kanë numër të njëjtë të deputetëve, si përcaktohet radha e tyre në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës?

51. Lidhur me të lartcekurat, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata:

> (i) *"interpretimin e nocionit "grupi më i madh parlamentar" në kontekst të ndarjes së vendeve në KQZ për grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në kuptim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës" duke u bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës;* dhe (ii) *"zgjidhje të konfliktit të autorizimeve të grupeve parlamentare për të propozuar anëtarët e KQZ-së", duke u bazuar në pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës.*

52. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës së Presidentes bazuar në (i) paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës; dhe (ii) pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës.

(i) Përkitazi me vlerësimin e pranueshmërisë në kontekst të paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës

53. Lidhur me këtë, parashtruesja e kërkesës pretendon se Kushtetuta i jep të drejtë Presidentes që të kërkojë interpretim të çështjeve kushtetuese kur kemi të bëjmë me paqartësi rreth frymës së Kushtetutës. Sipas saj kjo mbështetet edhe në faktin se e drejta për të referuar çështje kushtetuese, është vendosur nën "ombrellën" e kompetencave të Presidentes bazuar në nenin 84 të Kushtetutës, kështu duke mos u kufizuar në kërkesa të tjera dhe duke sugjeruar për një interpretim të gjerë të kuptimit të çështjeve kushtetuese.

54. Parashtruesja e kërkesës pretendon se në rastin konkret janë përmbushur kriteret e kërkuara për pranueshmërinë e saj në bazë të nenit 84 (9) të Kushtetutës. Kjo pasi: (i) ndarja e numrit të propozimeve të emërimeve të anëtarëve në KQZ nuk rregullohet me ndonjë akt tjetër përveçse me Kushtetutë, çka vërteton se kërkesa është "çështje e pastër kushtetuese"; (ii) Kushtetuta i referohet Gjykatës Kushtetuese si autoritetit kompetent dhe përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës; dhe (iii) kërkesa buron nga Neni 84, paragrafi 9 i Kushtetutës me të cilin parashihet referimi çështjeve kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese si një nga funksionet e Presidentes.

55. Në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës mban qëndrimin se "*paqartësia e kompetencave po i pamundëson Presidentes që ti emërojë të gjithë anëtarët e KQZ-së, si organ i cili i administron dhe menaxhon zgjedhjet e lira, të barabarta dhe të drejtpërdrejta në Kosovë*".

56. Përkitazi me kompetencën e parashtrueses së kërkesës për të parashtruar kërkesë para Gjykatës duke u bazuar ekskluzivisht në nenin 84 (9) të Kushtetutës, Gjykata i referohet parimeve të përcaktuara nga praktika e saj gjyqësore në raste të ngjashme.

57. Gjykata thekson se në kontekst të parashtrimit të kërkesave para saj duke u bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës, ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore dhe e cila, ndër tjerash, thekson se mundësia e Presidentit për të referuar çështje kushtetuese në kontekst të paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës duhet të kuptohet në lidhje me dispozitat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës të përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës. Më saktësisht, paragrafi 9 i nenit 84 të Kushtetutës, nuk mund të shërbejë si bazë e ndarë dhe e pavarur nga neni 113 i Kushtetutës dhe se kompetenca e Presidentit që të "referojë çështje kushtetuese" siç është përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 84 të Kushtetutës duhet të jetë e ndërlidhur me nenin 113 të Kushtetutës. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KO79/18, *parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës*, Kërkesë

për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 dhjetorit 2018, paragrafët 72, 74, 77, 78 dhe 82; KO131/18 *parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës,* Aktvendim për Papranueshmëri i 6 marsit 2019, paragrafi 90; dhe KO181/18, *parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës*, Aktvendim për Papranueshmëri i 13 qershorit 2019, paragrafi 46).

58. Për më tepër, Gjykata ka theksuar se duke u nisur nga fakti që Kushtetuta ka përcaktuar shprehimisht juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, përfshirë edhe palët e autorizuara për aktivizimin e juridiksionit të saj, Gjykatës i është kufizuar mundësia që të marrë rol konsultativ apo këshillëdhënës, ngase ky rol do të binte ndesh me rolin e saj themelor për vendosjen e rasteve të ngritura para saj (shih, rastin KO79/18, cituar më lart, paragrafi 76).

59. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se neni 84 (9) i Kushtetutës, duhet të ndërlidhet me juridiksionin e Gjykatës të përcaktuar me nenin 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës, e cila përcakton shprehimisht dhe në mënyrë shteruese çështjet që Presidenti i Republikës mund t'ia referojë Gjykatës Kushtetuese.

60. Prandaj, Gjykata rithekson se neni 84 (9) i Kushtetutës nuk mund të shërbej si bazë e vetme juridike për parashtruesen e kërkesës për të parashtruar kërkesë për interpretim para Gjykatës Kushtetuese dhe rrjedhimisht, Gjykata gjen se kërkesa e parashtrueses së kërkesës për interpretim të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, është e papranueshme për shqyrtim.

(ii) Përkitazi me vlerësimin e pranueshmërisë në kontekst të pikës (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës

61. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Presidentja, në cilësinë e parashtrueses ka ngritur gjithashtu rast të konfliktit të kompetencës kushtetuese në mes të grupeve parlamentare, si trupa të Kuvendit.

62. Parashtruesja e kërkesës pretendon lidhur me këtë se: *"[...] në rastin konkret përmbushen tri kërkesat e ngërthyera në nenin 113 paragrafi 3, nën-paragrafi 1 të Kushtetutës të zbërthyera nga Gjykata në rastin nr. KO131/18 sepse: (i) konflikti ngrehet nga njëra prej tri palëve të autorizuara e që është Presidentja e Republikës së Kosovës; (ii) konflikti ngrehet për një kompetencë kushtetuese të caktuar, në këtë rast për nominimin dhe emërimin e anëtarëve të KQZ-së siç parashihet në nenin 139, paragrafi 4 i Kushtetutës; (iii) konflikti ekziston meqë nominimi për anëtarë në KQZ, e cila është kompetencë*

e grupeve parlamentare si trupa të Kuvendit, i paraprinë emërimit të anëtarëve të KQZ-së, si kompetencë e Presidentes së Republikë së Kosovës.[...].”

63. Gjykata i referohet edhe njëherë nenit 113.3.(1) të Kushtetutës që përcakton se Presidenti i Republikës së Kosovës është një nga tri palët e autorizuara që të ngre çështje të “*konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës*”.

64. Gjykata më tutje i referohet edhe kërkesave ligjore të përcaktuara me nenin 31 [Saktësimi i kërkesës] dhe 32 [Afatet] të Ligjit si dhe rregullin 68 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës dhe nenet 31 dhe 32 të Ligjit] të Rregullores së punës, si dispozita që e konkretizojnë më tutje dispozitën e lartcekur kushtetuese për “*konflikt në mes të kompetencave kushtetuese*”:

Neni 31
[Saktësimi i kërkesës]

Kërkesa e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës parashtrohet nga cilado palë e autorizuar në konflikt ose nga cilado palë e autorizuar që cenohet drejtpërdrejtë nga i njëjti konflikt. Kërkesa përmban çfarëdo informate të dobishme në lidhje me konfliktin e supozuar në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 32
[Afatet]

Kërkesa e ngritur në bazë të nenit 31 të këtij ligji parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve nga çasti i lindjes së konfliktit.

Rregulli 68
[Kërkesa në pajtim me nenin 113.3 (1) të Kushtetutës dhe nenet 31 dhe 32 të Ligjit]

(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.3, të Kushtetutës dhe me nenet 31 dhe 32 të Ligjit.
(2) Kur parashtron kërkesën në pajtim me këtë rregull, pala e autorizuar duhet të specifikojë saktë se çfarë konflikti ekziston ndërmjet kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës,

Presidentit të Republikës së Kosovës ose Qeverisë së Republikës së Kosovës.
(3) Pala e autorizuar duhet të identifikojë aktin, i cili shkel kompetencën e tij/saj dhe dispozitën përkatëse të Kushtetutës, e cila është shkelur nga një akt i tillë.
(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga dita në të cilën ka filluar konflikti i pretenduar.
(5) Sekretariati do të njoftojë autoritetin, akti i të cilit kontestohet. Ata mund të përgjigjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e njoftimit, përveç nëse tregohet arsye e mirë për një kohë më të gjatë dhe nëse zgjatja përkatëse miratohet

65. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton interpretimin e saj përmes praktikës gjyqësore të saj se neni 113.3 (1) i Kushtetutës ngërthen në vete tri kushte të nivelit kushtetues, të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, përkatësisht domosdoshmërinë që:

(i) konflikti të ngritët nga njëra nga tri palët e autorizuara;
(ii) çështja të ngritët për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuara; dhe,
(iii) të ketë një konflikt (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KO131/18, cituar më lart, paragrafi 92; dhe KO181/18, cituar më lart, paragrafi 58).

66. Për sa i takon kushtit (i), Gjykata ka theksuar që neni 113.3 (1) i Kushtetutës e autorizon Kuvendin, Presidentin dhe Qeverinë që të ngrenë rast të konfliktit në mes të kompetencave të tyre kushtetuese. Ky autorizim është i ndërsjellë dhe secili prej këtyre palëve të autorizuara mund të ngrenë çështje të konfliktit të kompetencave për njërën apo palën tjetër, duke mos përjashtuar mundësinë e ngritjes së konfliktit kundrejt dy palëve njëkohësisht. Në rastin konkret, kjo kërkesë kushtetuese plotësohet me faktin që kërkesa është parashtruar nga Presidentja, si njëri nga tri palët e mundshme që janë të autorizuara për të ngritur çështje të konfliktit në mes të kompetencave të Qeverisë dhe Kuvendit.

67. Për sa i takon kushtit (ii), Gjykata vëren që neni 113.3 (1) i Kushtetutës përcakton që konflikti mund të ngritët vetëm për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuara. Ndonëse Kushtetuta e lë të hapur objektin e konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese, ajo bën një kufizim të rëndësishëm lidhur me atë se konflikti i supozuar i kompetencës kushtetuese duhet të burojë patjetër nga kompetencat kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë për Presidentin, Kuvendin dhe Qeverinë. (Shih, rastet e

Gjykatës Kushtetuese: KO131/18, cituar më lart, paragrafi 94 KO181/18, cituar më lart, paragrafi 60).

68. Andaj, në vazhdim Gjykata duhet të vlerësojë nëse, në rastin konkret, është plotësuar kriteri (ii) kushtetues, pra nëse në rastin konkret konflikti i supozuar ngritët për "*kompetencë kushtetuese*" ndërmjet Presidentes të Republikës, Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës.

69. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesja në kërkesën saj kërkon interpretimin e nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës, i cili përcakton që:

> *"Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtar emërohet nga deputetë të Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë".*

70. Gjykata rikujton po ashtu dispozitat relevante të Kushtetutës që përcaktojnë:

> *Neni 84*
> *[Kompetencat e Presidentit]*
> *[...]*
> *(26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;*
> *[...]*
>
> *Neni 139*
> *[...]*
>
> *[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]*
> *[...]*
>
> *3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli.*
> *[...]*

71. Në këtë drejtim, Gjykata sjell në vëmendje dispozitën e nenit 61.3.a të Ligjit Nr.03/L073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e

Kosovës, i cili parashikon: *"[...] a. Brenda dhjetë (10) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, grupet parlamentare me të drejtë të caktimit të anëtarit (ve) në KQZ e njoftojnë Presidentin e Kosovës për nominimin e tyre. Pas sigurimit se individi i caktuar nga grupi parlamentar i përshtatet kërkesave të këtij ligji, Presidenti i Kosovës, brenda pesë (5) ditëve e konfirmon me shkrim emërimin. Emërimi hyn në fuqi në ditën e shënuar në Emërimin zyrtar nga Presidenti i Kosovës."*

72. Gjykata vëren se neni 84 [Kompetencat e Presidentit] dhe paragrafët 3 dhe 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës, përcaktojnë kompetencën kushtetuese të Presidentes për emërimin e Kryesuesit të KQZ-së dhe mënyrën e emërimit të anëtarëve të këtij të fundit, por kompetenca e Presidentes për emërimin e anëtarëve të KQZ-së nuk është e përcaktuar me Kushtetutë, por vetëm me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht me pikën (a) të paragrafit 3 të nenit 61 të tij. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese: KO79/18, cituar më lart, paragrafi 81). Duke marrë parasysh që konflikti i kompetencave, në rrethanat e rastit konkret, është ngritur përkitazi me një kompetencë të Presidentes dhe e cila nuk është përcaktuar me Kushtetutë, Gjykata, bazuar në pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës dhe praktikës së saj gjyqësore përmes të cilës ka interpretuar këtë dispozitë, thekson se konflikti i kompetencave nuk është ngritur përkitazi me "kompetenca kushtetuese" të Presidentes dhe për pasojë, nuk është plotësuar kriteri i dytë kushtetues në kontekst të ngritjes së "konfliktit të kompetencave" kushtetuese për Presidentin, Kuvendin dhe/ose Qeverinë. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese: KO131/18, cituar më lart, paragrafët 102-106). Marrë parasysh që kriteri i dytë kushtetues në kontekst të nenit 113.3.1 të Kushtetutës, nuk është plotësuar në rrethanat e rastit konkret, Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, konsideron se nuk është e nevojshme të vlerësojë kushtin (iii) të pranueshmërisë së kërkesës, respektivisht, nëse ekziston "konflikti" në mes të kompetencave të Presidentit, Qeverisë dhe Kuvendit. (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese: KO181/18, cituar më lart, paragrafi 72).

73. Prandaj në vlerësimin e Gjykatës në rrethanat e rastit konkret, Presidentja e Republikës ndonëse është palë e autorizuar që të ngritë çështje të konfliktit të kompetencave kushtetuese në mes të saj dhe Kuvendit, nuk ka ngritur para Gjykatës konflikt të "*kompetencave kushtetuese*", sipas përcaktimeve të nenit 113.3.(1) të Kushtetutës, dhe për pasojë, Gjykata shpall kërkesën e Presidentes së Republikës së Kosovës të papranueshme bazuar në nenin 113 të Kushtetutës.

Kërkesa për masë të përkohshme

74. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesja e kërkesës ka kërkuar caktimin e masës së përkohshme "*[...] Nevoja për masë të përkohshme për rrjedhjen e afateve bëhet sidomos relevante për faktin se brenda këtij viti do të organizohen zgjedhjet lokale, dhe është e domosdoshme që veprimet të cilat ndërmerren nga Presidentja në lidhje me emërimin e anëtarëve të KQZ-së të jenë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*"

75. Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e Përkohshme] të Ligjit, që parashikon:

> *"1.Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë ë nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të paripareushme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.*
>
> *2.Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale".*

76. Gjykata veçse ka vlerësuar se kërkesa është papranueshme bazuar nenin 113, paragrafi 1, të Kushtetutës dhe rrjedhimisht edhe kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet.

77. Gjykata refuzon kërkesën për caktimin e masës së përkohshme.

Përfundim

78. Në seancën shqyrtuese të mbajtur më 2 korrik 2021, Gjykata shqyrtoi rastin KO88/21, përkatësisht kërkesën e Presidentes së Republikës së Kosovës për (i) "*interpretimin e nocionit "grupi më i madh parlamentar" në kontekst të ndarjes së vendeve në KQZ për grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në kuptim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;* dhe (ii) *"për zgjidhje të konfliktit të autorizimeve të grupeve parlamentare për të propozuar anëtarët e KQZ-së*".

79. Gjykata vëren se bazuar në faktet e këtij rasti, rezulton se (i) më 22 prill 2021, Presidentja e Republikës kishte dërguar kërkesë tek grupet parlamentare për nominimin e kandidatëve për anëtarë të KQZ-së;

dhe (ii) në mes të datave 29 prill 2021 dhe 12 maj 2021, grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilat nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të garantuara, përkatësisht LVV, PDK, LDK dhe AAK, kishin propozuar anëtarët përkatës, ndërsa subjektet politike të cilat mbajnë vende të garantuara për komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë, gjithashtu kishin dorëzuar nominimet e tyre.

80. Presidentja e Republikës së Kosovës, më 12 maj 2021, ka emëruar tetë (8) anëtarë të KQZ-së. Dy (2) anëtarët e tjerë nuk janë emëruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, sepse (i) LVV ka propozuar tre (3) kandidatë për anëtarë të KQZ-së, ndërsa PDK ka propozuar dy (2) kandidatë për anëtarë të KQZ-së, dhe duke pretenduar "*paqartësi*" në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës që përcakton se "*nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë*", Presidentja e Republikës së Kosovës i është drejtuar Gjykatës me kërkesën për interpretim të "*grupit më të madh parlamentar*" në kontekst të dispozitës së lartcekur, përkatësisht nëse vendet e lira në KQZ i takojnë vetëm *grupit* apo *grupeve* më të mëdha parlamentare; dhe (ii) komuniteti boshnjak, në strukturën aktuale të Kuvendit, është i përfaqësuar përmes tri (3) subjekteve të ndryshme politike me numër të barabartë të ulëseve në Kuvend, ndërsa në Presidencë janë dorëzuar tri (3) propozime nga ky komunitet, ndonëse të njëjtit i takon vetëm një (1) vend në KQZ. Rrjedhimisht, Presidentja e Republikës gjithashtu pretendon "*paqartësi*" në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, përkitazi me emërimin e anëtarëve të KQZ-së nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë, në rastet kur një komunitet përfaqësohet nga më shumë subjekte politike, por me numër të barabartë ulësesh në Kuvend.

81. Në kontekst të rrethanave të lartcekura dhe duke theksuar se "*paqartësia e kompetencave po i pamundëson Presidentes që ti emërojë të gjithë anëtarët e KQZ-së, si organ i cili i administron dhe menaxhon zgjedhjet e lira, të barabarta dhe të drejtpërdrejta në Kosovë*", Presidentja e Republikës së Kosovës i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me (i) kërkesën për interpretimin e nocionit të "*grupit më të madh parlamentar*" në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, duke u bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës; dhe (ii) kërkesën për zgjidhjen e konfliktit të "*autorizimeve*" të grupeve parlamentare për të propozuar anëtarët e KQZ-së, duke u bazuar në pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës.

Përkitazi me vlerësimin e pranueshmërisë në kontekst të paragrafit 9 të nenit 84 të Kushtetutës

82. Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës së Presidentes për interpretim të paqartësive kushtetuese bazuar në paragrafin 9 të nenit 84 të Kushtetutës dhe kërkesën përkatëse për përgjigjen në katër (4) pyetje të parashtruara para Gjykatës dhe të cilat do të reflektohen në tërësi në Aktvendimin për Papranueshmëri që do të publikohet në përputhje me rregullat procedurale në ditët në vijim, Gjykata konstatoi që kërkesa e Presidentes është e papranueshme. Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore, duke përfshirë rastin KO79/18, në të cilin gjithashtu është trajtuar një kërkesë e Presidentit të Republikës për interpretimin e paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, ka qartësuar që (i) paragrafi 9 i nenit 84 të Kushtetutës nuk është i pavarur nga neni 113 i Kushtetutës; (ii) paragrafi 9 i nenit 84 dhe paragrafi 1 i nenit 112 të Kushtetutës nuk mund të interpretohen jashtë kontekstit të nenit 113 të Kushtetutës; dhe (iii) bazuar në nenin 113 të Kushtetutës, Gjykatës i është kufizuar mundësia që të marrë rol konsultativ apo këshillëdhënës përmes përgjigjes në pyetje të parashtruara para saj, ngase ky rol do të binte ndesh me rolin e saj themelor për vendosjen e rasteve të ngritura para saj.

Përkitazi me vlerësimin e pranueshmërisë në kontekst të pikës (1) të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës

83. Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës së Presidentes, bazuar në pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës, përkitazi me zgjidhjen e konfliktit të "*autorizimeve*" në mes të "*kompetencës kushtetuese*" të Presidentes dhe "*kompetencës së grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvend*" për nominimin e anëtarëve të KQZ-së, Gjykata fillimisht theksoi se neni i lartcekur i Kushtetutës përcakton që Presidenti i Republikës së Kosovës është një nga tri palët e autorizuara që të ngre çështje të "*konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës*". Kjo dispozitë është interpretuar nga Gjykata përmes Aktvendimeve në rastet KO131/18 dhe KO181/18, duke sqaruar tri kriteret kumulative kushtetuese të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që kërkesat e ngritura në bazë të këtij neni të kalojnë testin e pranueshmërisë. Në rastet e lartcekura, Gjykata kishte sqaruar se në kuptim të nenit 113.3.(1) të Kushtetutës, duhet të plotësohen tri kriteret në vijim: (i) konflikti të ngritët nga njëra nga tri palët e autorizuara; (ii) konflikti të ngritët për "*kompetenca kushtetuese*" të Kuvendit, Presidentit dhe/ose Qeverisë së Republikës së Kosovës; dhe që (iii) të ketë një konflikt.

84. Gjykata vlerësoi se në rrethanat e këtij rasti është plotësuar kriteri i parë kushtetues, sepse kërkesa është dorëzuar në Gjykatë nga

Presidentja e Republikës së Kosovës, si njëra nga tri palët e autorizuara. Megjithatë, Gjykata konstatoi se kriteri i dytë kushtetues në kontekst të nenit 113.3.(1) të Kushtetutës, nuk është plotësuar, sepse siç ka sqaruar Gjykata në rastet KO131/18 dhe KO181/18, konflikti i supozuar duhet të burojë nga kompetencat kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë për palët e autorizuara. Në rrethanat e rastit konkret, për dallim nga nenet 84 (26), 139 (3) dhe 139 (4) të Kushtetutës, e të cilat përcaktojnë kompetencën kushtetuese të Presidentes për emërimin e Kryesuesit të KQZ-së dhe mënyrën e emërimit të anëtarëve të këtij të fundit, kompetenca e Presidentes për emërimin e anëtarëve të KQZ-së nuk është e përcaktuar me Kushtetutë, por vetëm me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht me pikën (a) të paragrafit 3 të nenit 61 të tij.

85. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Gjykatës, në rrethanat e rastit konkret, Presidentja e Republikës nuk ka ngritur para Gjykatës konflikt të "*kompetencave kushtetuese*", sipas përcaktimeve të nenit 113.3.(1) të Kushtetutës, dhe për pasojë, Gjykata shpalli kërkesën e Presidentes së Republikës së Kosovës të papranueshme bazuar në nenin 113 të Kushtetutës dhe refuzoi kërkesën për caktim të masës së përkohshme bazuar në nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 1 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 59 (2) të Rregullores së punës, më 2 korrik 2021, me shumicë votash

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për caktim të masës së përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;

IV. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 te Ligjit;

V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatën Kushtetuese**
Bajram Ljatifi	Gresa Caka-Nimani

KI187/20, Parashtrues: Lorik Salihu, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN. nr. 558/2020, të 18 gushtit 2020

KI187/20, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 qershorit 2021, publikuar më 05.08.2021

Fjalët kyç*: e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjet juridik, kërkesë e papranueshme, qartazi e pabazuar*

Nga shkresat e lëndës rezultoi që rasti ndërlidhet me sekuestrimin e automjetit të parashtruesit të kërkesës, i cili është bërë me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, kërkesë kjo e miratuar nga Gjykata Themelore, nën dyshimin se automjeti i sekuestruar është përdorur nga parashtruesi i kërkesës për kryerjen e veprës penale, të cilën vepër dyshohet se e kishte kryer. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore kundër Urdhrit për lejimin e sekuestrimit të veturës. Gjykata Themelore kishte refuzuar ankesën, dhe në këshillën juridike të aktvendimit të saj ishte shënuar që ndaj të njëjtit vendim, palët mund të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në afat prej 3 (tri) ditësh. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit kishte hedhur poshtë ankesën si të palejuar, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte udhëzuar parashtruesin e kërkesës, pasi që bazuar në nenin 417, paragrafin 5 të KPPRK-së në këtë rast specifik nuk është e lejuar ankesa.

Parashtruesi i kërkesës, si pretendim kryesor para Gjykatës Kushtetuese kishte ngritur shkeljen e të drejtës të mbrojtur me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

Lidhur me nenin 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës vetëm kishte përmendur por nuk kishte elaboruar apo arsyetuar tutje para Gjykatës se si ka ardhur deri tek shkelja e të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me këtë nen.

Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendoi para Gjykatës se atij i është cenuar e drejta në mjet juridik, sepse sipas tij ankesën e tij të parashtruar në Gjykatën e Apelit e kishte bazuar në nenin 24 në ndërlidhje me nenin 378 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në këshillën juridike të Aktvendimit të Gjykatës Themelore. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendoi se mjeti juridik kishte qenë në dispozicion të parashtruesit dhe i paraparë me dispozita ligjore. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se vendimi i kontestuar është kontradiktor, duke shtuar se sipas tij dispozita e paragrafit 5 të nenit 417 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së

Kosovës, vlen vetëm me përjashtim të rasteve, dhe sipas tij jo edhe në rastin konkret.
Gjykata së pari theksoi se pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në esencë ndërlidhet me interpretim të gabuar të ligjit të aplikueshëm.
Gjykata konstatoi se pavarësisht nga e drejta kushtetuese për një mjet efektiv juridik, është e rëndësishme të theksohet se jo çdo udhëzim i gabuar për një mjet juridik do të rezultojë në shkelje të së drejtës për mjet efektiv juridik.
Gjykata lidhur me rastin theksoi se refuzimi i ankesës në fjalë nuk e cenon të drejtën e parashtruesit për mjet juridik sepse ai mund të ushtroj të drejtën e tij për çështjen lidhur me rastin konkret përmes një ankese kundër aktgjykimit final.
Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk kishte dëshmuar dhe nuk i kishte mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI187/20

Parashtrues

Lorik Saliu

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN. nr. 558/2020, të 18 gushtit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Lorik Saliu, nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Edona Sina, avokate nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi [PN. nr. 558/2020] i 18 gushtit 2020 i Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Apelit) në lidhje me Aktvendimin [PPr. Kr. nr. 33/20] të 13 korrikut 2020 të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

3. Parashtruesi i kërkesës, Aktvendimin [PN. nr. 558/2020] e 18 gushtit 2020 të Gjykatës së Apelit, e ka pranuar më 26 gusht 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, përmes së cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 21 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet postës, dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 30 dhjetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

8. Më 14 janar 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që, në përputhje me nenin 21 të Ligjit dhe rregullin 32 (2) (c) të Rregullores së punës, të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim të parashtruesit të kërkesës.

9. Më 20 janar 2021, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi para Gjykatës autorizimin për përfaqësim.

10. Më 16 mars 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.

11. Më 12 prill 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një parashtresë, përmes së cilës plotësoi pretendimet e tij.

12. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

13. Më 18 maj 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Gjakovë për regjistrim të rastit dhe kërkoi nga ta që të dorëzojnë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar vendimin e kontestuar.

14. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

15. Më 31 maj 2021, Gjykata Themelore në Gjakovë, dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.

16. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

17. Më 30 qershor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se më 8 qershor 2020, Prokuroria Themelore në Gjakovë, përmes kërkesës [PP/I. nr. 36/20] drejtuar Gjykatës Themelore, kishte kërkuar vendosjen e urdhëresës për sekuestrim të përkohshëm të automjetit “BMW 335 D” (në tekstin e mëtejmë: automjeti) të parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se

ekziston dyshimi i bazuar se i njëjti është përdorur nga parashtruesi i kërkesës për qëllime të kryerjes së veprës penale "*Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge*" nga neni 267, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 "*Bashkëkryerja"* të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK).

19. Më 11 qershor 2020, Gjykata Themelore përmes Urdhëresës [PPr. Kr. nr. 33/20] duke u bazuar në paragrafin 1, 3 dhe 5 të nenit 112 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPRK-së) kishte urdhëruar sekuestrimin e përkohshëm të automjetit, të parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se "*është e domosdoshme sekuestrimi i përkohshëm i automjetit të bëhet me qëllim të verifikimit të kryerjes së veprës penale*".

20. Më 10 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Themelore kundër Urdhëresës së lartpërmendur të Gjykatës Themelore, me propozimin që e njëjta të pushohet, duke u thirrur në paragrafin 1 të nenit 116 të KPPRK-së. Parashtruesi i kërkesës, më tej kishte pretenduar se sekuestrimi i automjetit në këtë rast nuk është më i nevojshëm, duke theksuar se pas kontrolleve të nevojshme nga zyrtarët policorë, nuk ka asnjë bazë që automjeti të mbetet i sekuestruar edhe më tutje.

21. Më 13 korrik 2020, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [PPr. Kr. nr. 33/20] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se " *me këtë rast ekziston dyshimi i bazuar se automjeti i sekuestruar nga i pandehuri është përdorur për kryerjen e kësaj vepre penale, gjë që shihet edhe nga fotografitë që janë prova në lëndë*". Aktvendimi i Gjykatës Themelore u vendos në bazë të nenit 112 dhe 417 të KPPRK-së.

22. Në kështillën juridike të Aktvendimit [PPr. Kr. nr. 33/20], parashtruesi udhëzohet sipas mjetit juridik - ankesa kundër aktvendimit të lartpërmendur lejohet në afat prej 3 ditësh në Gjykatën e Apelit.

23. Më 22 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar zbatim të gabuar të dispozitave penale.

24. Më 18 gusht 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN. nr. 558/2020] kishte hedhur poshtë si të palejuar ankesën e parashtruesit me arsyetimin se "*Ankesa është e palejuar*" duke theksuar se gjykata

e shkallës së parë gabimisht kishte udhëzuar parashtruesin e kërkesës me këshillën juridike dhe se pretendimet e tilla në bazë të nenit 417.5 [Shqyrtimi nga Kolegji shqyrtues i Gjykatës Themelore] të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPRK) mund të parashtrohen vetëm përmes ankesës ndaj aktgjykimit final. Gjykata e Apelit Aktvendimin e saj e bazoi në nenin 400 lidhur me nenin 416, paragrafi 2 të KPPRK-së.

25. Më 23 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, përmes Kërkesës [PP/I.nr.36/20] kishte kërkuar kthimin e automjetit.

26. Nga shkresat e rastit rezulton se deri më tani Prokuroria Themelore në Gjakovë nuk ka kthyer përgjigje në kërkesën e lartcekur të parashtruesit të kërkesës për kthimin e automjetit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [PN. nr. 558/2020] i 18 gushtit 2020 i Gjykatës së Apelit, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.

28. Lidhur me pretendimin për shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesi thekson se "*I pandehuri përmes mbrojtëses së tij ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës Themelore në Gjakovë, bazuar në nenin 24 par.6 të Kodit të Procedurës Penale, ku është përcaktuar se: "afati për paraqitje të ankesave kundër vendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake apo të Kolegjit shqyrtues është pesë ditë prej kur pala e pranon vendimin, në pajtim me nenin 378.", mirëpo Gjykata e Apelit, si gjykatë kompetente për të vendosur lidhur me këtë ankesë e ka hedhur si të palejuar ankesën e mbrojtjes me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka udhëzuar me këshillën juridike dhe se pretendimet e tilla mund të parashtrohen vetëm përmes ankesës ndaj aktgjykimit final*".

29. Parashtruesi më tej shton se "*në rastin konkret mjeti juridik ka qenë në dispozicionin e parashtruesit, dhe i njëjti e ka shfrytëzuar atë në përputhje me dispozitat ligjore. Megjithatë efektiviteti i tij ka qenë inekzistent, si pasojë e mostrajtimit meritor. Rrjedhimisht ka sjellur deri tek shkelja e nenit 31 të Kushtetutës [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 32 [E drejta për*

Mjet Juridik], neni 13 i KEDNJ-së, meqë autoritetet vendase të cilat vendosin lidhur me rastin duhen të shqyrtojnë bazueshmërinë/meritat e kërkesës që rrjedh nga Konventa (shih, mutatis mutandis, Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 20 shtator 1999, Smith dhe Grady kundër Mbretërisë se Bashkuar, nr.33985/96dhe 33986/96par,138)duke supsimuar fakte t e parashtruesit nën ombrellën e jurisprudencës së GJEDNJ-së si dhe nenit 13 të KEDNJ-së, konkretisht mund të thuhet se: legjislacioni ynë e ka paraparë parashtrimin e ankesës kundër aktvendimit të kolegjit penal/shqyrtues, mjet ky që ka qenë i qasshëm ligjërisht, mirëpo në praktikë është provuar tërësisht inefektiv - si pasojë e interpretimit flagrant të dispozitave ligjore nga ana e Gjykatës se Apelit - interpretim ky që ka rezultuar të mos lëshohet fare në meritat e rastit - dhe ka sjellë deri te cenimi i të drejtës për mjet efektiv juridik të paraparë me nenin 32 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 13 të KEDNJ-së".

30. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson se vendimi i kontestuar është kontradiktor për faktin se sipas tij dispozita e paragrafit 5 të nenit 417 të KPPK-së, vlen vetëm me përjashtim të rasteve, dhe sipas tij jo edhe në rastin konkret.

31. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Dispozitat relevante ligjore

Kodi 04/L-123 i Procedurës Penale

Neni 24
[Urdhrat dhe vendimet e gjyqtarit të procedurës paraprake]

[...]

6. Afati për paraqitje të ankesave kundër vendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake apo të Kolegjit shqyrtues është pesë (5) ditë prej kur pala e pranon vendimin, në pajtim me nenin 378 të këtij Kodi.

Neni 116
[Kthimi i sendeve të sekuestruara përkohësisht]

1. Sendet e sekuestruara përkohësisht gjatë procedurës penale i

kthehen pronarit ose poseduesit kur procedura pezullohet ose pushohet dhe kur nuk ka bazë për konfiskimin e tyre.

Neni 378
[Afati për paraqitjen e kundërshtimit, kërkesës për mjet juridik dhe përgjigjes]

1. *Kundërshtimi i cili shqyrtohet nga Kolegji shqyrtues duhet të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.*

2. Kërkesa e cila shqyrtohet nga Gjykata e Apelit duhet të paraqitet brenda pesë (5) ditëve nga aktgjykimi apo aktvendimi i formës së prerë, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.

3. Kërkesa e cila shqyrtohet nga Gjykata Supreme e Kosovës duhet të paraqitet brenda dhjetë (10) ditëve, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.

4. Përgjigja në kundërshtim duhet të paraqitet brenda njëzet e katër (24) orëve nga kundërshtimi i cili shqyrtohet nga Kolegji shqyrtues.

5. Përgjigja në kërkesë duhet të paraqitet brenda pesë (5) ditëve nga kërkesa e cila shqyrtohet nga Gjykata e Apelit.

6. Përgjigja në kërkesë duhet të paraqitet brenda dhjetë (10) ditëve nga kërkesa e cila shqyrtohet nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Neni 400
[Hedhja e ankesës së palejueshme]

Gjykata e Apelit me aktvendim e hedh ankesën si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa, apo kur ankesa është tërhequr, ose kur ankesa e tërhequr paraqitet sërish apo ankesa nuk është e lejuar me ligj.

Neni 417
[Shqyrtimi nga Kolegji shqyrtues i Gjykatës Themelore]

[...]

5. Përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Kod, aktvendimi i Kolegjit shqyrtues mbi kundërshtimin shqyrtohet nga Gjykata e Apelit vetëm në bazë të ankesës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

34. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".

35. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [PN. nr. 558/2020] të 18 gushtit 2020, të Gjykatës së Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me Ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

36. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) në veçanti përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

37. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të

nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

38. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me sekuestrimin e automjetit të parashtruesit të kërkesës, i cili është bërë me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, kërkesë kjo e miratuar nga Gjykata Themelore, nën dyshimin se automjeti i sekuestruar është përdorur nga parashtruesi i kërkesës për kryerjen e veprës penale, të cilën vepër dyshohet se e ka kryer. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore, kundër Urdhrit për lejimin e sekuestrimit të veturës. Gjykata Themelore kishte refuzuar ankesën, dhe në këshillën juridike të Aktvendimit të saj ishte shënuar që ndaj të njëjtit vendim, palët mund të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në afat prej 3 (tri) ditësh. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit, kishte hedhur poshtë ankesën si të palejuar, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë e kishte keq udhëzuar parashtruesin, pasi që bazuar në nenin 417, paragrafin 5 të KPPRK-së në këtë rast specifik nuk është e lejuar ankesa.

39. Gjykata rikujton edhe një herë pretendimet e parashtruesit për shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

40. Së pari, lidhur me nenin 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës vetëm ka përmendur por nuk ka elaboruar apo arsyetuar tutje se si ka ardhur deri tek shkelja e të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me këtë nen.

41. Lidhur me pretendimin e lartcekur të parashtruesit për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e Aktvendimit të Gjykatës Apelit apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33)

42. Së dyti, lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i është cenuar e drejta në mjet juridik, sepse sipas tij ankesën e tij të parashtruar në Gjykatën e

Apelit e kishte bazuar në nenin 24 në ndërlidhje me nenin 378 të KPPRK-së, si dhe duke u bazuar në këshillën juridike të Aktvendimit [PPr. Kr. nr. 33/20] të Gjykatës Themelore, e cila parasheh se "*Kundër këtij Aktvendimi, është lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh, pas marrjes së tij, Gjykata e Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate*".

43. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se mjeti juridik kishte qenë në dispozicion të parashtruesit dhe i paraparë me dispozita ligjore. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se vendimi i kontestuar është kontradiktor, duke shtuar se sipas tij dispozita e paragrafit 5 të nenit 417 të KPPK-së, vlen vetëm me përjashtim të rasteve, dhe sipas tij jo edhe në rastin konkret.

44. Në shqyrtimin e këtyre pretendimeve, Gjykata thekson se pretendimi i tij përkitazi me shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në esencë ndërlidhet me interpretim të gabuar të ligjit të aplikueshëm nga Gjykata e Apelit, pretendime të cilat, Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, i konsideron si pretendime që hyjnë në sferën e ligjshmërisë, dhe rrjedhimisht "*pretendime të shkallës së katërt*".

45. Në këtë kontest, Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës ndërlidhen me interpretimin e paragrafit 5 të nenit 417 të KPPRK-së, nga ana e Gjykatës së Apelit, e cila duke u thirrur në nenin e lartcekur, ankesën e parashtruesit të kërkesës, të ushtruar kundër Aktvendimit [PPr. Kr. nr. 33/20] të 13 korrikut 2020 të Gjykatës Themelore, e kishte hedhur poshtë si të palejuar dhe në këtë mënyrë i kishte shkelur të drejtën për mjet juridik, duke ia mohuar parashtruesit të kërkesës përdorimin e mjetit juridik i cili, sipas parashtruesit të kërkesës, ishte ekzistent në bazë të nenit 24 në ndërlidhje edhe me nenin 378 të KPPRK-së.

46. Gjykata fillimisht vëren se Aktvendimi [PPr. Kr. nr. 33/20] i 13 korrikut 2020, të Gjykatës Themelore ishte nxjerrë nga trupi gjykues në përbërje prej tre gjyqtarësh dhe esenca e rastit kishte të bënte me çështjen e provave të mbledhura në procedurë paraprake penale.

47. Gjykata Themelore në këtë rast duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruesit, të ushtruar kundër Urdhëresës së Gjykatës Themelore, me të cilën ishte urdhëruar sekuestrimi i përkohshëm i automjetit, të parashtruesit të kërkesës, me qëllim të verifikimit të kryerjes së veprës penale, përmes Aktvendimit kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

48. Gjykata vëren se neni 116 i KPPRK-së parasheh se "*Sendet e sekuestruara përkohësisht gjatë procedurës penale i kthehen pronarit ose poseduesit kur procedura pezullohet ose pushohet dhe kur nuk ka bazë për konfiskimin e tyre*".

49. Gjykata, megjithatë thekson se Gjykata e Apelit, e kishte trajtuar ankesën e parashtruesit të kërkesës të ushtruar kundër Aktvendimit [PPr. Kr. nr. 33/20] të 13 korrikut 2020, të Gjykatës Themelore dhe duke u bazuar në nenin 417.5 të KPPRK-së të njëjtën e kishte hedhur poshtë si të palejuar. Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [PN. nr. 558/2020], të 18 gushtit 2020, në këtë kontekst, kishte theksuar si në vijim:

> " *Gjykata e Apelit, gjen se ankesa e ushtruar nga mbrojtësja e të pandehurit Lorik Salihu, av.Edona Sina, kundër vendimit të Kolegjit shqyrtues të Gjykatës Themelore është e palejuar, kjo pasi që bazuar në dispozitën e nenit 417, par. 5 të KPPRK-se, parashihet që: "Përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Kod, aktvendimi i Kolegjit shqyrtues mbi kundërshtimin shqyrtohet nga Gjykata e Apelit vetëm në bazë të ankesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore ", e që në rastin konkret Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtën e ushtrimit të mjetit juridik. Andaj, meqenëse ne rastin konkret nuk lejohet treshkallshmëria e mjeteve juridike me përjashtim të rasteve të parapara me ligj, ankesa e mbrojtëses së të pandehurit u hodh si e palejuar".*

50. Në adresimin e pretendimit të lartcekur, Gjykata fillimisht sjell në vëmendje dispozitën e nenit 32 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

> Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]
>
> *Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.*

51. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se neni 417.5 i KPPRK-së, në të cilin u thirr Gjykata e Apelit, në pjesën relevante thekson si në vijim:

> *[Shqyrtimi nga Kolegji shqyrtues i Gjykatës Themelore]*
>
> *[...]*

"5. Përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Kod, aktvendimi i kolegjit shqyrtues mbi kundërshtimin shqyrtohet nga Gjykata e Apelit vetëm në bazë të ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës themelore."

52. Në vijim të asaj çka u tha më lart, Gjykata vëren se vetë përmbajtja e dispozitës ligjore të nenit 417, paragrafit 5 të KPPRK-së është e pakontestueshme dhe se ankesa, mund të ushtrohet vetëm kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, pra vendimit të nxjerrë përkitazi me meritat e rastit.

53. Gjykata thekson se realizimi i të drejtës për mjet juridik, duke përfshirë edhe bazat për shfrytëzimin e tij, rregullohen me ligj. Ky nen plotësohet dhe lexohet në lidhshmëri edhe me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, si dhe me praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së.

54. Rrjedhimisht, neni 13 i KEDNJ-së kërkon që kur një individ ka një pretendim të argumentueshëm për të qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të përcaktuara në Konventë, në ato rrethana ai duhet të ketë një mjet juridik para një *"autoriteti"* kombëtar në mënyrë që të vendoset kërkesa e tij; dhe nëse është e përshtatshme, të marrë dëmshpërblim (shih rastet e GJEDNJ-së: *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 6 shtatorit 1978, paragrafi 64; *Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 25 marsit 1983, paragrafi 113; *Leander kundër Suedisë*, Aktgjykim i 26 marsit 1987, paragrafi 77 (a), po ashtu shih rastin e Gjykatës, KI62/20, parashtrues *Gekos Sh.p.k*, Akvendim për papranueshmëri, i 24 shkurtit 2021, paragrafi 48, KI130/19, parashtrues *Fahri Mati,* Aktvendim për papranueshmëri, i 27 nëntorit 2019, paragrafi 50).

55. Megjithatë, GJEDNJ ka theksuar që neni 13 i KEDNJ-së nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që kërkon një mjet juridik në të drejtën vendore për sa i përket secilës ankesë të supozuar që një individ mund të ketë, pa marrë parasysh se sa jo meritore mund të jetë ankesa e tij: ankesa dhe pretendimi duhet të jenë të "argumentueshme" për sa i përket KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së: *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 27 prillit 1988, paragrafi 52; *Maurice kundër Francës*, Aktgjykim i 6 tetorit 2005, paragrafi 106).

56. Bazuar në parimet e lartcekura, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës nuk është i argumentueshëm, pasi që KPPRK, në nenin 417.5 parasheh, "*Aktvendimi i Kolegjit shqyrtues*

mbi kundërshtimin shqyrtohet nga Gjykata e Apelit vetëm në bazë të ankesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore".

57. Duke iu rikthyer kësaj çështjeje, Gjykata do të vlerësojë nëse këshilla për mjetin juridik në vendimin e Gjykatës Themelore në ndonjë mënyrë a e ka penguar parashtruesin e kërkesës që të shqyrtohet pretendimi i tij ankimor nga gjykata e instancës më të lartë, në rastin konkret të Gjykatës së Apelit, ku ai do të mund të kishte ushtruar të drejtat e tij nga kërkesëpadia, ose mohimi i përdorimit të këshillës për mjetin juridik e Gjykatës Themelore kishte mohuar drejtpërdrejt të drejtën e parashtruesit për një mjet efektiv juridik, dhe me këtë drejtpërdrejt ka ardhur deri të shkelja e nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

58. Në dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata konstaton se pavarësisht nga e drejta kushtetuese për një mjet efektiv juridik, është e rëndësishme të theksohet se jo çdo udhëzim i gabuar për një mjet juridik do të rezultojë në shkelje të së drejtës për mjet efektiv juridik.

59. Dhe për më tepër në kuptimin e mjetit juridik , parashtruesi nuk mund të thirret në faktin që gjykata e shkallës së parë gabimisht autorizoi (udhëzoi) palën që ka të drejtë të apelojë kundër vendimit të Gjykatës Themelore, pasi që një udhëzim i tillë i gabuar në një situatë specifike ligjore nuk mund të zëvendësojë normën e qartë ligjore e cila për situata të tilla nuk parasheh mjet ankimi, siç parashihet me nenin 417.5 të KPPRK-së.

60. Gjykata rithekson se refuzimi i ankesës në fjalë nuk e cenon të drejtën e parashtruesit për mjet juridik sepse ai mund të ushtroj të drejtën e tij për çështjen lidhur me rastin konkret përmes një ankese kundër aktgjykimit final (shih në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës, KI145/13, parashtrues Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 marsit 2014, paragrafi 46).

61. Gjykata, në fund, rikujton se parashtruesi i kërkesës, në mbështetje të pretendimeve të tij për shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] iu referua edhe një rasti të GJEDNJ-së [...*"Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 20 shtator 1999, Smith dhe Grady kundër Mbretërisë se Bashkuar, nr.33985/96dhe 33986/96par,par138"...].* Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në rastin e referuar nga parashtruesi i kërkesës, GJEDNJ në vlerësimin e meritave të kërkesës, ndryshojnë plotësisht nga rrethanat faktike dhe juridike të rastit të parashtruesit të kërkesës.

GJEDNJ në rastin në të cilin thirret parashtruesi i kërkesës kishte gjetur shkelje të nenit 8 në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

62. Megjithatë, Gjykata vëren se përveç faktit që parashtruesi i kërkesës i është referuar këtij rasti në kërkesën e tij, ai në asnjë mënyrë nuk elaboroi lidhshmërinë e tyre, faktike apo juridike, me rrethanat e rastit konkret, detyrë kjo që, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i takon parashtruesit të kërkesës (shih, ndër të tjera, dhe në këtë kontekst, Aktgjykimin në rastin KI48/18 të 4 shkurtit 2019, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës* (LDK), paragrafi 275; dhe rastin KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 majit 2019, paragrafi 80).

63. Duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës. Për pasojë, Gjykata konstaton se ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

64. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk i ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë.

65. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe e njëjta deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 30 qershor 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Gresa Caka-Nimani

KI59/21, Parashtrues: Partia Demokratike e Kosovës, dega në Gjakovë, kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 416/2020, të 5 nëntorit 2020

KI59/21, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2021, publikuar më 12.08.2021

Fjalët kyç*: e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë e papranueshme, person juridik, qartazi e pabazuar*

Nga shkresat e lëndës rezultoi që rasti ndërlidhej me lidhjen e një kontrate për qiranë, ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit si administratore e ndërmarrjeve shoqërore. Si rezultat i mospagesës së obligimeve kontraktuese nga parashtruesi i kërkesës, respektivisht për pagesën e borxhit të qirasë për periudhën 1 qershor 2012 deri më 1 nëntor 2015, Agjencia Kosovare e Privatizimit kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore, dhe në ndërkohë kishte kërkuar plotësimin e kërkesëpadisë duke kërkuar që parashtruesi i kërkesës të paguajë edhe kamatë. Gjykata Themelore kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe e obligoi parashtruesin e kërkesës që të paguajë borxhin në emër të qirasë së papaguar, në bazë të kontratës mbi qiranë, me kamatë përkatëse ligjore të cilën e paguajnë bankat komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara në afat mbi një vit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi si të pabazuar. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Apelit, ku ndër të tjera parashtruesi e kontestoi edhe legjitimitetin pasiv dhe aktiv të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në këtë çështje, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar. Parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, dhe kjo e fundit refuzoi revizionin kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, e ndryshoi vetëm sa i përket datës prej kur duhet të paguhet kamata.

Parashtruesi i kërkesës, si pretendim kryesor para Gjykatës Kushtetuese kishte ngritur shkeljen e të drejtës të mbrojtur me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Parashtruesi i kërkesës në thelb para Gjykatës pretendoi se vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë mjaftueshëm të arsyetuara, respektivisht çështjet si në vijim i) mungesës së arsyetimit që i kanë bërë gjykatat e rregullta pretendimit të parashtruesit, lidhur me mungesën e legjitimitetit pasiv dhe aktiv të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për të qenë palë në procedurë; ii) pretendimit se gabimisht është konstatuar fakti se parashtruesi i kërkesës është person juridik; dhe iii) se Agjencia Kosovare e Privatizimit është përfaqësuar në mënyrë jo të drejtë para gjykatave të

rregullta, respektivisht jo në mënyrën e paraparë me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e praktikës së saj gjyqësore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me doktrinën e shkallës së katërt, dhe më pas aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.
Gjykata, lidhur me këto pretendime, konkludoi se të njëjtat janë çështje të ligjshmërisë që i takojnë kategorisë së pretendimeve të *"shkallës së katërt"*, rrjedhimisht, pretendime qartazi të pabazuara.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI59/21

Parashtrues

Partia Demokratike e Kosovës, dega në Gjakovë

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 416/2020, të 5 nëntorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Partia Demokratike e Kosovës, dega në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), e cila përfaqësohet nga Ylli Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 416/2020] të 5 nëntorit 2020 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në ndërlidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 1067/2016] të 16 korrikut 2020, të Gjykatës së Apelit.

3. Parashtruesi i kërkesës, Aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 27 nëntor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 mars 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), e të cilën, kjo e fundit e pranoi më 23 mars 2021.

7. Më 29 mars 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.

8. Më 15 prill 2021, Gjykata (i) e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës; dhe (ii) kërkoi nga ai dorëzimin e formularit të kërkesës, si dhe të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

9. Më 27 prill 2021, Gjykata pranoi nga parashtruesi i kërkesës formularin e kërkesës si dhe parashtruesi informoi Gjykatën se nuk e posedon fletëkthesën e kërkuar.

10. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së

punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

11. Më 18 maj 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Gjakovë për regjistrim të kërkesës si dhe kërkoi nga ajo të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.

12. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

13. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit Nr.K.SH.KI 59/21, emëroi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi si anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.

14. Më 31 maj 2021, Gjykata Themelore në Gjakovë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.

15. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohet kryesuese në kolegje shqyrtuese në rastet ku është caktuar si anëtare e Kolegjit, duke përfshirë rastin aktual.

16. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

17. Më 22 korrik 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit-Zyra Rajonale në Pejë (në tekstin e mëtejmë: AKP), më 30 maj 2012, kishin lidhur Kontratën për Qiranë [nr. 324/3], në bazë të së cilës ishin dakorduar që parashtruesi i kërkesës t' i shfrytëzojë zyrat që gjinden në anën e majtë të objektit të N. SH

"Deva", në Gjakovë, dhe për çka duhet të paguajë shumën në vlerë prej 500 euro në muaj.

19. Si rezultat i mospagesës së qirasë, në një datë të paspecifikuar, AKP kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) kundër parashtruesit të kërkesës për pagimin e qirasë së objektit të lartpërmendur, për periudhën 1 qershor 2012 deri më 1 nëntor 2015, në shumën e përgjithshme prej 20.500,00 euro.

20. Më 18 nëntor 2015, AKP përmes një parashtrese drejtuar Gjykatës Themelore kishte kërkuar zgjerimin e kërkesëpadisë duke kërkuar që parashtruesi i kërkesës të paguajë kamatën përkatëse ligjore si dhe shumën prej 500 euro deri në dorëzimin e objektit.

21. Më 30 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës kishte dërguar një parashtresë në Gjykatën Themelore, përmes së cilës e kishte kontestuar legjitimitetin pasiv të AKP-së lidhur me këtë çështje dhe gjithashtu kishte kontestuar edhe zgjerimin e kërkesëpadisë.

22. Më 5 janar 2016, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C. nr. 122/13] pjesërisht kishte aprovuar kërkesëpadinë e AKP-së, dhe në këtë mënyrë kishte obliguar parashtruesin e kërkesës si në vijim: i) në emër të qirasë së papaguar prej 1 qershorit 2012 deri më 1 nëntor 2015, në bazë të kontratës mbi qiratë t' i paguajë AKP-së shumën prej 20.500,00 euro me kamatë përkatëse ligjore të cilën e paguajnë bankat komerciale në Kosovë për mjete të deponuara në afat mbi një vit, dhe e cila fillon të rrjedhë nga 18 nëntori 2015; ii) të paguajë shpenzimet procedurale; iii) pjesën tjetër të kërkesëpadisë dhe që ka të bëjë për pagesën e shumës në vlerë prej 500 euro për periudhën deri në dorëzimin e objektit, e refuzoi në tërësi si të pabazuar.

23. Ndër të tjera, Gjykata Themelore në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, në arsyetimin e Aktgjykimit të lartpërmendur theksoi "*lidhur me pretendimet e të autorizuarit të paditur, se paditësja nuk ka legjitimitet nuk qëndrojnë pasi që nga viti 2008 AKP i menaxhon ndërmarrjet shoqërore dhe se e paditura me kërkesën e saj iu është drejtuar paditëses për lëshimin e objektit me qira të cilat ka rezultuar te nënshkrimi i kontratës mbi qiranë e cila kontratë për palët është ligj [...]*".

24. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore duke pretenduar, shkelje esenciale të dispozitave

të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

25. Më 16 korrik 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1067/2016] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe vërtetoi Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit në arsyetimin e Aktgjykimit të saj konsideroi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte i drejtë, dhe nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se gjendja faktike ishte vërtetuar drejtë. Tutje lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se parashtruesi i kërkesës nuk është person juridik dhe se AKP-së i mungon legjitimiteti pasiv, Gjykata e Apelit i refuzoi si të pabazuara.

26. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit duke pretenduar, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

27. Më 5 nëntor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 416/2020] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, ndërsa Aktgjykimin [C. nr. 122/13] e Gjykatës Themelore, e ndryshoi vetëm sa i përket kamatës duke e obliguar parashtruesin që shumën prej 19,440.00 euro ta paguajë me kamatë përkatëse ligjore duke filluar nga 8 prilli 2016, deri në pagesën definitive.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar [Rev. nr. 416/2020] të 5 nëntorit 2020 të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

29. Parashtruesi i kërkesës fillimisht pretendon se Aktgjykimi [Ac. nr. 1067/2016] i 16 korrikut 2020, nuk është mjaftueshëm i arsyetuar, duke pohuar se përmes këtij të fundit nuk është arsyetuar pretendimi i parashtruesit të kërkesës lidhur me mungesën e legjitimitetit aktiv dhe pasiv që AKP të jetë palë në procedurë, si dhe faktin se AKP-ja para gjykatave të rregullta nuk është përfaqësuar në mënyrën e paraparë më Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

30. Parashtruesi i kërkesës më tutje lidhur me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, pretendon se gabimisht është konstatuar fakti se

parashtruesi i kërkesës është person juridik dhe se AKP-ja nuk është përfaqësuar në mënyrë të drejtë para gjykatave të rregullta. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon "*Gjykata Supreme e Kosovës, ka konstatuar gabimisht kur ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejt që, Partia Demokratike e Kosovës, përkatësisht Dega në Gjakovë, ka legjitimitet në procedurë duke ju referuar nenit 23, par 1 të statutit të PDK-së*".

31. Parashtruesi i kërkesës tutje pretendon se "*Konsideroj se është shkelur rëndë parimi i ligjshmërisë në nivel të lartë, e bazuar në analizën e vendimeve gjyqësore të atakuara me këtë kërkesë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, vihet te konkludimi se gjykatat e rregullta kanë aplikuar dispozita ligjore përkatëse në mënyrë të gabuar ose arbitrare dhe të njëanshme me çka kanë shkelur seriozisht garancionet kushtetuese*".

32. Në mbështetje të pretendimeve për mungesë të arsyetimit të vendimeve të gjykatave të rregullta, parashtruesi i kërkesës është thirrur në një numër të madh rastesh të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), respektivisht në rastet *(Talpis kunder Italisë,* Aktgjykim i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e përmendura aty, *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992*; Van de Hurk kundër Holandës,* Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës,* Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës, 27 shtatorit 2001; Suominen kundër Finlandës,* Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës,* Aktgjykim i 18 korrikut 2006; *dhe Tatishvili kundër Rusisë,* Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007) si dhe rasteve të Gjykatës (*KI72/12, Veton Berisha dhe Ilfete Haziri,* Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16*, Naser Husaj,* Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *"IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018; dhe KI143/16, *Muharrem Blaku dhe të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018.

33. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallë të pavlefshëm vendimin e kontestuar, respektivisht, Aktgjykimin [Rev. nr. 416/2020] të 5 nëntorit 2020 të Gjykatës Supreme.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> [...]
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

36. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".*

37. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë si për individët ashtu edhe për personat juridikë për aq sa janë të zbatueshme (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI118/18, me parashtrues, *Eco Construction sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 tetorit 2019, paragrafi 29 dhe referencat e përdorura aty).

38. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
> *2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

39. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 416/2020] e 5 nëntorit 2020 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

40. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

"Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

41. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e

kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

42. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t' iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *"të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*".

43. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

44. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me lidhjen e një kontrate për qiranë, ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe AKP-së si administratore e ndërmarrjeve shoqërore. Si rezultat i mospagesës së obligimeve kontraktuese, respektivisht për pagesën e borxhit të qirasë për periudhën 1 qershor 2012 deri më 1 nëntor 2015, në shumën e përgjithshme prej 20.500,00 euro, AKP-ja kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore, dhe në ndërkohë kishte kërkuar plotësimin e kërkesëpadisë duke kërkuar që parashtruesi i kërkesës të paguajë edhe kamatë, si dhe shumën në vlerë prej 500 euro në muaj deri në realizimin e plotë të borxhit. Gjykata Themelore kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e AKP-së dhe e obligoi parashtruesin e kërkesës që në emër të qirasë së papaguar prej 1 qershorit 2012 deri më 1 nëntor 2015, në bazë të kontratës mbi qiratë t' i paguajë AKP-së shumën prej 20.500,00 euro me kamatë përkatëse ligjore të cilën e paguajnë bankat komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara në afat mbi një vit, e cila fillon të rrjedhë nga 18 nëntori 2015, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi si të pabazuar. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Apelit, ku ndër të tjera parashtruesi e kontestoi edhe legjitimitetin pasiv dhe aktiv të AKP-së në këtë çështje, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar. Parashtruesi

parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, dhe kjo e fundit refuzoi revizionin kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore e ndryshoi vetëm sa i përket, datës prej kur duhet të paguhet kamata.

45. Gjykata rikujton se këto konstatime të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, parashtruesi i kërkesës i konteston para Gjykatës, duke pretenduar në esencë, shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore, në mënyrë specifike Aktgjykimit [Rev. nr. 416/2020] të 5 nëntorit 2020 të Gjykatës Supreme në ndërlidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 1067/2016] të 16 korrikut 2020, të Gjykatës së Apelit.

46. Fillimisht, Gjykata rikujton se pretendimet të cilat parashtruesi i kërkesës i ngritë në Gjykatë, të njëjtat i ka ngritur edhe para gjykatave të rregullta dhe që kanë të bëjnë kryesisht me mungesën e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, respektivisht: i) mungesës së arsyetimit që i kanë bërë gjykatat e rregullta pretendimit të parashtruesit, lidhur me mungesën e legjitimitetit pasiv dhe aktiv të AKP-së për të qenë palë në procedurë; ii) pretendimit se gabimisht është konstatuar fakti se parashtruesi i kërkesës është person juridik; dhe iii) se AKP-ja është përfaqësuar në mënyrë jo të drejtë para gjykatave të rregullta, respektivisht jo në mënyrën e paraparë me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

47. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së, e cila ka vlerësuar se, edhe pse autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar që sistemet e tyre gjyqësore të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 6. 1 të KEDNJ-së, gjykatat e tyre duhet "*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre*" (shih *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, kërkesa nr. 12945/87, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic*", Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 45, shih rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 majit 2018, paragrafi 54).

48. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së, edhe kjo Gjykatë, në një mori rastesh, ka theksuar se megjithëse gjykatat nuk janë të detyruara të adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesit e kërkesave, gjykatat kanë për obligim të adresojnë pretendimet qendrore për rastet para tyre (shih, *mutatis mutandis,* rastin e sipërcekur të Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 53). Në këtë aspekt, e drejta për të marrë një

vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, si në nivelin procedural ashtu edhe në atë material (shih, *mutatis mutandis,* rastin e sipërcekur të Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 54).

49. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht vëren që Gjykata Supreme e kishte refuzuar si të pabazuar revizionin e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 1067/2016] të 16 korrikut 2020, të Gjykatës së Apelit. Së pari, përkitazi me pretendimet specifike të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme nuk i ka adresuar pretendimet e tij të paraqitura në revizion, Gjykata i referohet pjesës relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme e cila arsyeton:

> "*Thëniet në revizion se aktgjykimet e instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, siç theksohet se nuk janë siguruar provat vendimtare për vërtetimin e pronësisë në lokalin kontestues, dhe se nuk është vërtetuar legjitimiteti i palës paditëse, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pabazuara. Në mënyrë të pakontestuaeshme është vërtetuar se paditësi është pronar i lokalit dhe me asnjë provë e paditura nuk e ka kontestuar këtë. Pretendimet e cekura në revizion që kanë qenë objekt shqyrtimi edhe para gjykatës së shkallës së dytë e cila me të drejtë e ka vlerëzuar se e paditura Partia Demokratike e Kosovës e ka legjitimitetin e palës në procedurë, Gjykata Supreme e i aprovon edhe për faktin se sipas web- faqes zyrtare ku është publikuar statuti i të paditurës, përcaktohet në nenin 7, që i referohet statutit legal se "PDK është person juridik me të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga Ligjet e Republikës së Kosovës dhe është e regjistruar në regjistrin zyrtar të organizatave politike" Ndërsa në nenin 23. 1. E definon se Degët e PDK-së janë forma më e lartë e organizimit në nivelin lokal.*
>
> *Pretendimet ankimore se pala paditëse është përfaqësuar në mënyrë të paligjshme Gjykata Supreme i refuzon si të pabazuara . Sipas Ligjit nr. 03/1-067, Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit [...] i zbatueshëm në rastin konkret, është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitje, transferimin dhe/ose likuidimin- e ndërmarrjeve dhe aseteve të përkufizuara me këtë ligj. Në procedurë pala paditëse përveç Elmaze Nushit në emër të Këshillit Menaxhues të Bankës është përfaqësuar nga Ilmi Miftaraj me autorizim të dhënë nga AKP*".

50. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet edhe Aktgjykimit [Ac. nr. 1067/2016] të 16 korrikut 2020, të Gjykatës së Apelit, përmes së cilit lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se nuk është person juridik dhe se AKP-së i mungon legjitimiteti pasiv, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 122/13] e Gjykatës Themelore. Gjithashtu, Gjykata rikujton arsyetimin e Aktgjykimit [C. nr. 122/13] e 5 janarit 2016, të Gjykatës Themelore i cili thekson "*lidhur me pretendimet e të autorizuarit të paditur, se paditësja nuk ka legjitimitet nuk qëndrojnë pasi që nga viti 2008 AKP i menaxhon ndërmarrjet shoqërore dhe se e paditura me kërkesën e saj iu është drejtuar paditëses për lëshimin e objektit me qira të cilat ka rezultuar te nënshkrimi i kontratës mbi qiranë e cila kontratë për palët është ligj [...]*".

51. Nën dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata arrin në përfundimin se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Rev. nr. 416/2020] i 5 nëntorit 2020 është i qartë dhe adreson pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në revizion. Nuk ka ndonjë argument thelbësor të cilin Gjykata Supreme e ka lënë mënjanë si të paarsyetuar, siç pretendon parashtruesi i kërkesës.

52. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme ka arritur në këtë përfundim pasi që ka shqyrtuar arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore dhe nga Gjykata e Apelit.

53. Prandaj, Gjykata konsideron se përfundimet e Gjykatës Supreme janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme plotëson të gjitha standardet e nevojshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për një vendim gjyqësor të arsyetuar.

54. Gjykata, në rastin e parashtruesit të kërkesës, vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura në Gjykatë, kryesisht ngrisin çështje të ligjshmërisë dhe si të tilla nuk hyjnë në sferën e kushtetutshmërisë. Andaj, nën dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata gjithashtu konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Pekinel kundër Turqisë,* të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 55, shih, gjithashtu, në këtë aspekt, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43)

55. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë

shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t' i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rasti *García Ruiz* kundër *Spanjës,* GJEDNJ, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu, rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

56. Gjykata, në fund, rikujton se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendime të argumentueshme për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

57. Prandaj dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 22 korrik 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetues**
Bajram Ljatifi	Gresa Caka-Nimani

KI175/19; Parashtrues Ismajl Zogaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit [KMLC. nr. 129/2019] të Prokurorit të Shteti, të 13 gushtit 2019, Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, [Ac. nr. 3983/2018], të 24 majit 2019, dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-dega në Malishevë [C.nr. 118/2018] të 2 shkurtit 2018.

Fjalët kyç: kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta, mos zbatim i vendimit të përmbarueshëm.

KI 175/19, Aktgjykim i miratuar më 28 korrik 202, i publikuar më 13.08.2021

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës nga Komuna e Malishevës dhe me mos përmbarimin e Vendimit të KPMSHCK-së, [nr. 738], të 18 prillit 2006 i cili kishte obliguar Komunën e Malishevës që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e punës. Përmes padisë së tij, parashtruesi i kërkesës pretendoi para Gjykatës Komunale në Malisheve mosekzekutim të Vendimit të KPMSHCK-së nga Komuna e Malishevës për rikthimin e tij në vendin e punës. Gjykata Komunale në Malishevë përmes Aktgjykimit [C.nr.166/2007] e aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e cila kishte të bënte me pagesën e të ardhurave personale të humbura për periudhën kohore derisa kontrata e punës ka qenë valide, ndërsa e refuzoi pjesën e kërkesëpadisë që kishte të bëjë me kthim në vendin e tij të punës pas skadimit të vlefshmërisë së kontratës së punës për parashtruesin e kërkesë. Gjykata e Apelit, pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, përmes Aktgjykimit [Ac.nr.2942/2012] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.166/2007] e Gjykatës Komunale në Malishevë. Sipas Gjykatës se Apelit kontrata e punës se parashtruesit të kërkesës tashmë kishte skaduar dhe se nuk do të ishte ligjore dhe e logjikshme të urdhërohet që parashtruesi i kërkesës të kthehet në vendin e punës duke qenë se kontrata e lidhur kishte fuqi ligjore vetëm deri më 31 mars 2006. Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr. 6/2014] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se Vendimi i KPMSHCK-së paraqet vendim administrativ të formës se prerë, dhe si i tillë duhet të përmbarohet nga gjykata kompetente. Pas kthimit të rastit në shkallë të parë në rigjykim, Gjykata Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë përmes Aktvendimit [Cp.nr.490/2014] detyroi Komunën e Malishevës që ta kompensojë parashtruesin e kërkesës në emër të pagave mujore në vlerë prej 934.78 euro, por refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale pas skadimit të kontratës. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3536/15] vlerësoi se Aktvendimi [Cp.nr.490/2014] i Gjykatës Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë është nxjerrë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore. Parashtruesi i kërkesës bëri precizimin e saktë të propozimit për përmbarim të Vendimit të KPMSHCK-së pranë Gjykatës Themelore. Më 26 maj 2017, Gjykata Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë përmes Aktvendimit [Cp.nr.157/2016]: (i) aprovoi propozimin e parashtruesit të kërkesës; (ii) e detyroi Komunën e Malishevës që në bazë të vendimit të KPMSHCK-së, parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e punës; (iii) e detyroi Komunën e Malishevës që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë shpenzimet procedurale. Pas ankesës se Komunës se Malishevës, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.4085/17] anuloi Aktvendimin [Cp.nr.157/2016] e Gjykatës Themelore në Gjakovë – dega në Malishevë dhe e ktheu çështjen në shkallë të parë për riprocedim të serishëm. Gjykata Themelore në Gjakovë – dega në Malishevë, në riprocedurë përmes Aktvendimit [Cp.nr.118/2018] ia njohu parashtruesit të kërkesës vetëm të drejtën e kompensimit të të ardhurave financiare dhe atë vetëm për periudhën deri sa e ka pasur kontratën. Pas ankesës se parashtruesit, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3983/2018] vërtetoi Aktvendimin [Cp.nr.118/2018] e Gjykatës Themelore të 2 korrikut 2018. Ndërsa, Vendimi i KPMSHCK-së [nr. 738] i 18 prillit 2006, përmes së cilit ishte përcaktuar rikthimi i parashtruesit të kërkesës në vendin e punës, në tërësinë e tij nuk ishte përmbaruar asnjëherë nga Komuna e Malishevës.

Gjykata konstatoj se përmbarimi i Vendimit të KPMSHCK-së ka pasur direkt të bëjë me kthimin e parashtruesit të kërkesës në vendin e punës dhe jo vetëm me çështjen e kompensimit financiar në emër të pagave të papaguara gjatë periudhës se largimit nga puna.

Më tutje, duke u mbështetur në shkresat e lëndës që ajo posedon, Gjykata vërejti se përkundër përpjekjeve të pareshtura të parashtruesit të kërkesës që Vendimi i KPMSHCK-së të përmbarohet, ai vendim nuk është zbatuar asnjëherë dhe as nuk është shfuqizuar. Pra, kanë kaluar më tepër se 12 (dymbëdhjetë) vite nga nxjerrja e Vendimit të KPMSHCK-së (18 prill 2006) deri në vendimin e fundit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 3983/2018], të 24 majit 2019.

Prandaj, Gjykata thekson se zbatimi i një vendimi të formës së prerë dhe të detyrueshëm, brenda një afati të arsyeshëm, është e drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Në rrethanat e rastit konkret Gjykata konstatoj se mospërmbarimi i Vendimit të KPMSHCK-së, nr. 738, i 18 prillit 2006, nga Komuna e Malishevës dhe gjykatat e rregullta për një periudhe kohore kaq të gjatë që nga nxjerrja e Vendimit të KPMSHCK-së, për kthimin e parashtruesit të kërkesës në pozitën e tij të mëparshme përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së. Si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtruesi i kërkesës ishte privuar nga e drejta e tij për t'u rikthyer në vendin e punës në pajtim me urdhrin e Vendimit të KPMSHCK-së të nxjerrë në favor të tij.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI175/19

Parashtrues

Ismajl Zogaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit [KMLC. nr. 129/2019] të Prokurorit të Shteti, të 13 gushtit 2019, Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, [Ac. nr. 3983/2018], të 24 majit 2019, dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-dega në Malishevë [C.nr. 118/2018] të 2 shkurtit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ismajl Zogaj, nga Komuna e Malishevës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) i përfaqësuar nga Rrahman Kastrati, avokat nga Komuna e Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Njoftimin [KMLC.nr.129/2019] e Prokurorit të Shteti, të 13 gushtit 2019, Aktvendimin [Ac.nr.3983/2018] e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) të 24 majit 2019, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-dega në Malishevë [C.nr.118/2018] të 2 korrikut 2018.

3. Parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktvendimin [Ac.nr.3983/2018] e Gjykatës së Apelit, të 24 majit 2019 më 28 qershor 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit dhe Aktvendimeve të lartcekura përmes së cilëve, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 30 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 4 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.

8. Më 14 nëntor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë formularin zyrtar për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë dhe autorizimin për përfaqësim.

9. Më 20 dhjetor 2019, Gjykata u dërgoi kopjen e kërkesës Prokurorisë së Shtetit dhe Gjykatës se Apelit.

10. Më 3 shtator 2020, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) dhe kërkoi nga ajo dorëzimin e fletëkthesës që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës se Apelit.

11. Më 21 shtator 2020, Gjykata Themelore në Gjakovë-dega në Malishevë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.

12. Më 26 mars 2021, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen ta shtyjë për një seancë tjetër në përputhje me plotësimet e kërkuara.

13. Më 14 prill 2021, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta njoftojë nëse është kompensuar financiarisht nga Komuna e Malishevës.

14. Në po të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Komuna e Malishevës që ta njoftojë nëse i ka zbatuar vendimet e gjykatave të rregullta për akordimin e kompensimit financiar ndaj parashtruesit të kërkesës.

15. Më 19 prill 2021, parashtruesi i kërkesë e dorëzoi përgjigjen dhe e informoi Gjykatën se nuk është kompensuar nga Komuna e Malishevës.

16. Më 23 prill 2021, Komuna e Malishevës e dorëzoi përgjigjen dhe e informoi Gjykatën se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur kërkesë për ekzekutim të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.3983/2018], të 24 majit 2019.

17. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

18. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP-71-2/21], gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

19. Më 1 korrik 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe, njëzëri, i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe vlerësimin e çështjes në merita.

20. Në të njëjtën ditë, më 1 korrik 2021, Gjykata vendosi: (i) njëzëri që kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e pranueshme; (ii) njëzëri që mospërmbarimi i Vendimit të KPMSHCK-së, nr. 738, i 18 prillit 2006, ka shkaktuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) më shumicë votash të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [Ac.nr.3983/2018] e Gjykatës së Apelit, të 24 majit 2019, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë [C.nr.118/2018] të 2 korrikut 2018; (iv) njëzëri që të urdhërojë Komunën e Malishevës ta zbatojë Vendimin e KPMSHCK-së nr. 738, të 18 prillit 2006.

Përmbledhja e fakteve

21. Parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Komunën e Malishevës, në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në pozitën e zyrtarit të pylltarisë, sipas kontratës për një periudhë të caktuar nga 2 marsi 2005 deri më 31 mars 2006.

Procedura para Komisionit Disiplinor në Komunën e Malishevës

22. Më 21 tetor 2005, Komisioni Disiplinor i Komunës se Malishevës (në tekstin e mëtejmë: Komisioni Disiplinor) përmes Vendimit [06/769] ia ndërpreu marrëdhënien e punës parashtruesit të kërkesës.

23. Kundër Vendimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës u ankua pranë Komisionit të Ankesave në Komunën e Malishevës. Ky i fundit, më 23 dhjetor 2005, në cilësi të organit disiplinor të shkallës së dytë mori Vendimin [02/861] përmes së cilit, hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës duke konfirmuar Vendimin e Komisionit Disiplinor [06/769] të dhënë në shkallë të parë.

Procedura para Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës

24. Më 18 janar 2006, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMSHCK) kundër Vendimit [02/861] të Komunës së Malishevës.

25. Më 18 prill 2006, KPMSHCK nxori Vendimin [nr.738] përmes së cilit: (i) anuloi vendimin [02/861] e Komisioni për Ankesa në kuadër të Komunës së Malishevës; (ii) e detyroi Komunën e Malishevës që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e punës; (iii) kërkoi nga e njëjta që të zbatoje këtë vendim brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditësh.

26. Më specifikisht, KPMSHCK-ja përmes Vendimit [nr.738] konstatoi si në vijim:

> *"Aprovohet Ankesa 71/06 e 18.01.2006 e parashtruar nga Ismajl Zogaj me të gjitha pretendimet ankimore dhe anulohet vendimi i Komisionit të Ankesave i KK. Malishevë i 23.12.2005, nr. 02/861.*
>
> *Autorizohet Autoriteti Punëdhënës KK. i Malishevës që nëpunësin ta kthejë në vendin e punës Zyrtar i Pylltarisë në Drejtorinë për Bujqësi më të gjitha të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës nga data e largimit."*

27. Sipas parashtruesit të kërkesës *"ai në disa raste ka bërë përpjekje për tu kthyer në vendin e punës por Komuna e Malishevës nuk e ka zbatuar vendimin e lartcekur të KPMSHCK-së".*

Procedura pranë gjykatave të rregullta përkitazi me padinë e parashtruesit të kërkesës rreth zbatimit të Vendimit të KPMSHCK-së nr. 738 të 18 prillit 2006

28. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës ka ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Malishevë për kthim në vendin e punës, respektivisht për përmbushjen e Vendimit të KPMSHCK-së [nr.738]. Përmes padisë së tij, parashtruesi i kërkesës pretendonte mosekzekutim të vendimit të KPMSHCK-së nga Komuna e Malishevës për rikthimin e tij në vendin e punës.

29. Më 21 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Malishevë përmes Aktgjykimit [C.nr.166/2007] e aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e cila kishte të bënte me pagesën e të ardhurave personale të humbura për periudhën kohore derisa kontrata e punës ka qenë valide, ndërsa e refuzoi pjesën e kërkesëpadisë që kishte të bëjë me kthim në vendin e tij të punës pas skadimit të vlefshmërisë se kontratës së punës për parashtruesin e kërkesës.

30. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale në Malishevë, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës

kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

31. Më 1 nëntor 2013, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.2942/2012] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.166/2007] e Gjykatës Komunale në Malishevë. Sipas Gjykatës se Apelit kontrata e punës e parashtruesit të kërkesës tashmë kishte skaduar dhe se nuk do të ishte ligjore dhe e logjikshme të urdhërohet që parashtruesi i kërkesës të kthehet në vendin e punës duke qenë se kontrata e lidhur kishte fuqi ligjore vetëm deri më 31 mars 2006.

32. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës ushtroi revizion në Gjykatën Supreme duke u thirrur në zbatim të gabuar të të drejtës materiale dhe njëkohësisht kërkoi që lënda të kthehet në rigjykim.

33. Më 7 mars 2014, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.6/2014] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se vendimet e gjykatave paraprake ishin nxjerrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit është në kundërshtim me provat në shkresa të lëndës, andaj si i tillë i njëjti aktgjykim është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit dhe në fund ktheu rastin në rigjykim në shkallë të parë. Gjykata Supreme duke vendosur sipas revizionit të parashtruesit të kërkesës përmes Aktvendimit [Rev.nr.6/2014] kishte prishur Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë [C.nr.166/2007] të 21 dhjetorit 2011 dhe Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë [Ac.nr.2942/2012] të 1 nëntorit 2013 duke kthyer lëndën në rigjykim gjykatës së shkallës së parë, me udhëzimin e qartë që padinë e paditësit, ushtruar kundrejt të padituës, gjykata e shkallës së parë ta trajtojë si propozim për përmbarim, duke u pezulluar fillimisht procedura kontestimore e zhvilluar dhe procedura e mëtejme të vazhdojë sipas rregullave të procedurës përmbarimore me qëllim që të mund të zbatohet Vendimi i KPMSHCK-së [nr. 738] i 18 prillit 2006.

34. Ndër të tjera, Gjykata Supreme e arsyetoi vendimin e saj si në vijim:

> *"Paditësi në padinë e tij ka kërkuar zbatimin respektivisht përmbarimin në tërësi, të vendimit të lartëpërmendur të KPMSHCK-së, i cili gjendet në shkresa të lëndës, dhe gjykata e shkalles së parë ka qenë e detyruar që padinë e tij ta konsiderojë si propozim për përmbarim të këtij vendimi, dhe lëndën ta zhvillojë sipas rregullave të procedurës përmbarimore e jo që në*

kundërshtim me, petitumin (kërkesën) e padisë të zhvillojë procedurën sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe pas saj, të vendos në mënyre meritore me aktgjykim. Në kuptim të nenit 2.1 të LPK, gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse, andaj gjykata e shkallës se parë ka qenë e detyruar që të vendos sipas kërkesës së padisë për zbatimin e vendimit të lartpërmendur, i cili zbatim bëhet në procedurë përmbarimore, dhe në ketë kontekst gjykata ka mundur që ta udhëzojë palën paditëse; që padinë e paraqitur ta precizoëj dhe titullin si propozim për përmbarim, ose të njëjtën padi ta konsiderojë si propozim për përmbarim, dhe procedurën e mëtejme ta zhvillojë sipas rregullave të procedurës përmbarimore. Vendimi i lartpërmendur i KPMSHCK-së paraqet vendim administrativ të formës së prerë, dhe si i tillë duhet të përmbarohet nga gjykata kompetente sipas propozimit për përmbarim nga kreditori në kuptim të realizmit të së drejtës së fituar në procedurë administrative."

Procedura e parë në rivendosje përkitazi me padinë e parashtruesit të kërkesës rreth zbatimit të Vendimit të KPMSHCK-së [nr.738] të 18 prillit 2006

35. Sipas Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, rasti ishte kthyer në rivendosje në shkallë të parë ku parashtruesi i kërkesës kërkoi përmbarimin e Vendimit të KPMSHCK-së [nr.738] të 18 prillit 2006.

36. Sipas udhëzimit të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës kishte propozuar përmbarimin e vendimit të KPMSHCK-së.

37. Më 1 qershor 2015, Gjykata Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë në riprocedurë dhe rigjykim kishte caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën seancë duke trajtuar padinë e parashtruesit të kërkesës si propozim për përmbarim dhe duke vendosur që procedura e mëtejshme të zhvillohet sipas rregullave të procedurës përmbarimore kishte administruar dhe vlerësuar provat e propozuara nga palët. Me atë rast, Gjykata Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë përmes Aktvendimit [Cp.nr.490/2014]: (i) aprovoi pjesërisht propozimin e parashtruesit të kërkesës; (ii) detyroi Komunën e Malishevës që ta kompensojë parashtruesin e kërkesës në emër të pagave mujore në vlerë prej 934.78 euro; (iii) dhe refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale pas skadimit të kontratës.

38. Më 14 gusht 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-dega në Malishevë në Gjykatën e Apelit duke u ankuar për shkeljen e dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke kërkuar kthimin e tij në vendin e tij të punës, si dhe kompensimin e pagave të humbura.

39. Më 8 mars 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3536/15] aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vlerësoi se aktvendimi i lartcekur është nxjerrë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe vendosi se: *"vendimi i nxjerrë nga gjykata e shkalles së parë duhet prishur, me qellim që në riprocedurë gjykata e shkalles se parë t'i evitojë shkeljet e dispozitave të procedurës përmbarimore nga neni 36 parg. 1, 38 parg.1, 43 parg.1 dhe 44 të LPP".*

40. Në këtë rast, Gjykata e Apelit arsyetoi: "*Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK e lidhur me nenin 17 të LPP qëndrojnë për faktin se dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është në kundërshtim të plotë me provat nga shkresat e lëndës. Në bazë të aktvendimit të ankimuar nuk mund të kuptohet se gjykata e shkalës së parë a ka vendosur sipas rregullave të procedurës përmbarimore duke iu referuar Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës nr. 738 të datës 18.04.2006, i cili në këtë lëndë përmbarimore ka cilësinë e dokumentit ekzekutiv (titullit përmbarues), apo gjykata e shkallës se parë ka vendosur në mënyre meritore rreth kërkesëpadisë së paditësit sipas padisë fillestare të ushtruar, duke iu referuar tërësisht rregullave të procedurës kontestimore, veçmas kur kihet parasysh fakti se procedura përmbarimore ligjërisht është procedurë tejet formale dhe strikte, dhe se gjatë kësaj procedure organi përmbarues duhet të veprojë dhe zbatojë përmbarimin vetëm brenda detyrimit i cili parashihet me dokumentin përmbarues."* Për me tepër, Gjykata e Apelit shtoi se *"....gjykata e shkallës së parë prapë ka gjykuar dhe vendosur për një çështje për të cilën ka vendosur Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, me vendimin nr. 738 e datës 18.04.2006, i cili në bazë të nenit 22 parag. 1 pika 1.2 të LPP me të cilin shprehimisht thuhet: "Dokumentet përmbaruese janë vendimi përmbarues i dhënën ne procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia) ka cilësinë e dokumentit përmbarues, dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë tërësisht për bazë udhëzimet që i janë dhëne me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, kur lënda i ishte kthyer në rigjykim dhe rivendosje të njëjtës gjykatë".*

41. Gjykata e Apelit specifikisht theksoi se: *"Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore të nenit 36 dhe 38 të LPP, sepse në seancën e shqyrtimit kryesorë me rastin e vendosjes që padinë e paditësit ushtruar kundër të paditurit, ta trajtojë si propozim për përmbarim është dashur që në kuptim të nenit 38 parag. 2 të LPP e lidhur me nenin 102.1 të LPK ta ftojë kreditorin që brenda afatit kohor ligjor të bëjë rregullimin e propozimit për përmbarim, duke e udhëzuar që propozimi për përmbarim duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara siç parashihet me paragrafin 1 të nenit 38 të LPP si dhe ta obligojë kreditorin që gjykatës t'ia prezantojë origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit përmbarues të pajisur me klauzolë për permbarueshmeri kusht ky ligjor i paraparë me dispozitën e nenit 36 parag.1 të LPP*".

42. Gjykata e Apelit përfundimisht udhëzoi që: *"Gjykata e shkallës se parë të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore në pajtim me të gjeturat dhe vërejtjet e paraqitura më lartë nga Gjykata e Apelit, ashtu që fillimisht të ftojë kreditorin që brenda afatit kohor ligjor të bëjë ndreqje të propozimit për përmbarim dhe gjykatës t'ia prezantojë edhe origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit përmbarimor të pajisur me klauzolë të përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri, duke e njoftuar edhe për lëshimet procedurale në rast mosveprimi sipas urdhrit të gjykatës dhe pastaj, varësisht prej veprimit apo mosveprimit të kreditorit, të ndërmarrë hapat e mëtejmë proceduralë të paraparë me dispozitat ligjore të LPP-së"*.

43. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës sipas udhëzimit të Gjykatës së Apelit, bëri precizimin e saktë të propozimit për përmbarim të vendimit të KPMSHCK-së pranë Gjykatës Themelore.

44. Më 26 maj 2017, Gjykata Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë përmes Aktvendimit [Cp.nr.157/2016]: (i) aprovoi propozimin e parashtruesit të kërkesës; (ii) detyroi Komunën e Malishevës që në bazë të Vendimit të KPMSHCK-së, parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e punës; (iii) detyroi Komunën e Malishevës që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë shpenzimet procedurale.

45. Kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Gjakovë – dega në Malishevë, në cilësi të palës së interesuar, Komuna e Malishevës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit. Me atë rast, Komuna e Malishevës pretendoi se ishte bërë shkelje e dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim i gabuar i gjendjes faktike dhe aplikimi i gabuar i të drejtës materiale. Përkitazi me këtë,

Komuna e Malishevës kërkoi nga Gjykata e Apelit që ta aprovojë ankesën e saj si të bazuar si dhe të refuzojë Aktvendimin e Gjykatës Themelore [Cp.nr.157/16] të 26 majit 2017, si të pabazuar ose ta kthejë në rivendosje në bazë të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore (në tekstin e mëtejmë: LPP).

46. Më 22 shkurt 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.4085/17] anuloi Aktvendimin [Cp.nr.157/2016] të Gjykatës Themelore në Gjakovë – dega në Malishevë dhe e ktheu çështjen në shkallë të parë për riprocedim të serishëm. Gjykata e Apelit në ketë rast arsyetoi: *"Aktvendimi i atakuar i marrë nga gjykata e shkalles së parë, është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitës nga neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 199, të LPK-së, dhe nenit 36 paragrafi 1 të LPP-së, gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar që me rastin e marrjes së propozimit për përmbarim të vlerësojë nëse dokumenti i cili është paraqitur si titull përmbarues i plotëson kushtet siç është paraparë me dispozitën e nenit 36 të LPP-së, ku parashihet se: "se bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri. Vërtetimin për përmbarueshmërinë e jep gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës se parë. Më këtë rast Gjykata e Apelit udhëzoi "Gjykata e shkallës së parë sugjerohet që në riprocedurë sipas detyrës zyrtare të rishikojë se a janë plotësuar prezumimet procedurale të dispozitave të cekura më lartë lidhur me lejimin e përmbarimit, bazuar në dokumentin përmbarimor, e që në rastin konkret bazuar në vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, nr. 738 të datës 24.04.2016, ashtu që në përpikëri t'i zbatojë dispozitat e ligjit të procedurës përmbarimore e posaçërisht nenin 27 par., të LPP-së, lidhur me përshtatshmërinë e dokumentit përmbarimor".*

Procedura e dytë në rivendosje përkitazi me padinë e parashtruesit të kërkesës rreth zbatimit të Vendimit të KPMSHCK-së nr. 738 të 18 prillit 2006

47. Më 2 korrik 2018, Gjykata Themelore në Gjakovë – dega në Malishevë, në riprocedurë përmes Aktvendimit [Cp.nr.118/2018] aprovoi pjesërisht propozimin duke i njohur parashtruesit të kërkesës vetëm të drejtën e kompensimit të të ardhurave financiare dhe atë vetëm për periudhën deri sa e ka pasur kontratën.

48. Më specifikisht, në arsyetimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë theksohej me sa vijon:

"Gjykata pjesërisht e miratoi propozimin e kreditorit sa i përket kompensimit të pagave për periudhën prej datës kur kreditorit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, përkatësisht nga data 26.10.2005 deri me datën 31.03.2006 kur kreditorit i ka skaduar kontrata e punës. Kontrata e punës e kreditorit me debitorin ka qenë në kohë të caktuar, prandaj paga kreditorit i takon vetëm për kohen sa ka pasur vlefshmëri kohore kontrata e punës, për faktin se nuk ka qenë e sigurt se punëtorit, tani kreditorit do t'i vazhdohet kontrata e punës edhe pas skadimit të saj e cila ishte me afat të caktuar. Gjykata e refuzoi propozimin e kreditorit sa i përket kthimit në punë dhe detyra të punës se zyrtarit të pylltarisë në Drejtorinë për Pylltari me arsyetimin se kontrata e punës e kreditorit ka qenë në kohë të caktuar."

49. Kundër aktvendimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Në ankesën e tij, më konkretisht, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar/theksuar:

"Të detyrohet debitori, Komuna e Malishevës me seli në Malishevë dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, që kreditorin Ismajl Zogaj ta kthejë në vendin e punës Zyrtar për pylltari dhe t'ia paguajnë shumën prej 28,636.02 € në emër të pagave të humbura deri më 27.02.2015 (kur është punuar ekspertiza financiare) me plotësim të pagesës shtesë deri më datë 31.03.2017, shumën prej 8,601.55 € për paga si dhe 301.05 € interesi, ashtu që kjo llogaritje të vazhdojë deri në ditën e pagesës definitive."

50. Më 24 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3983/2018] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [Cp.nr.118/2018] e Gjykatës Themelore të 2 korrikut 2018.

51. Më 1 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës i propozoi Prokurorit të Shtetit që të ushtrojë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktvendimit [Cp.nr.118/2018] të Gjykatës Themelore të 2 korrikut 2018 dhe kundër Aktvendimit [AC.nr.3983/18] të Gjykatës së Apelit të 24 majit 2019. Në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuara anulimin e Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës se Apelit, dhe të kthejë rastin në rivendosje.

52. Më 13 gusht 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit përmes Njoftimit [KMLC.nr.129/2019] refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se pretendimet e cekura në propozim nuk janë të mjaftueshme për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 247, paragrafët a) dhe b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

53. Parashtruesi i kërkesës pretendon se mospërmbarimi i Vendimit të KPMSHCK-së, [nr. 738] i 18 prillit 2006, nga debitori Komuna e Malishevës, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

54. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"me aktvendimet e kontestuara gjyqësore i është mohuar e drejta e kthimit të tij në vendin e punës dhe realizimi i të gjitha të drejtave të tij të njohura sipas vendimit të KPMSHCK-së, nr, 738, të 24 prillit 2006, duke i njohur vetëm të drejtën e kompensimit të të ardhurave, për aq sa ka pasur afat kontrata e punës për kohë të caktuar ndërsa jo edhe kthimi në vendin e punës".*

55. Parashtruesi i kërkesës thekson si në vijim: "*Në këtë rast konsiderojmë se në të drejtën e kreditorit është shkelur ligji gjithsesi, duke pasur parasysh se obligimi për të zbatuar në plotni Vendimi i KPMSHCK-së, nuk ka ndodhë ashtu që e drejta e tij e vërtetuar nga ai vendim për tu kthyer në punë me të gjitha të drejtat ende nuk është zbatuar e po ashtu edhe përkundër të gjitha vërejtjeve për tu zhvilluar procedurë përmbarimore e gjithë çështja është zhvilluar plotësisht si procedurë kontestimore, duke iu mohuar e drejta për zbatimin e vendimit të KPMSHCK-së".*

56. Parashtruesi thekson specifikisht: "*Kthimi në vend të punës është kërkuar përmes padisë dhe jo propozimit pasi që vendimi i KPMSHCK, deri në vitin 2012 nuk është trajtuar si titull përmbarimor".* Parashtruesi tutje thekson: "*Nga paqartësia e fuqisë juridike të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës deri në nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nr.ref.Agj/282/12 të 17.07.2012, parashtruesi i kërkesës, ka kërkuar të drejtën e tij përmes padisë për kthim në vendin e punës."*

57. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

dhe nenin 13 të Protokollit nr. 11 të KEDNJ-së; (iii) të deklarojë të pavlefshëm Njoftimin [KMLC.nr.129/2019] të Zyrës se Kryeprokurorit të Shtetit të 13 gushtit 2018.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetua e Republikës se Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[....]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme"
[...]

RREGULLORJA E UNMIK-ut PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS, nr. 2001/36, 22 dhjetor 2001

Neni 11
Apelimi

11.3 Në rastet kur Këshilli bindet se vendimi i kundërshtuar ka shkelur parimin e parashtruar në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje, ai urdhëron një mjet të përshtatshëm juridik me shkrim dhe një urdhëresë që i drejtohet sekretarit të përhershëm apo përgjegjësit kryesor të organit përkatës të punësimit, i cili është përgjegjës për zbatimin e urdhrit të organit të punësimit.

11.4 Në rastet kur organi i punësimit përkatës nuk i përmbahet vendimit dhe urdhrit të Këshillit, Këshilli ia paraqet rastin Kryeministrit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

LIGJI Nr. 03/L-192 PËR KËSHILLIN E PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Neni 12
Ankesat

4. Në rastet kur Këshilli bindet se përmes vendimit të kundërshtuar janë shkelur parimet apo rregullat e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, ai nxjerr vendim me shkrim i cili i drejtohet zyrtarit të nivelit të lartë drejtues apo përgjegjësit kryesor të organit përkatës të punësimit, i cili është përgjegjës për zbatimin vendimit të Këshillit.

Neni 13
Vendimi i Këshillit

Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 15
Procedura në rast moszbatimi të vendimit të Këshillit

1. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Pranueshmëria e kërkesës

58. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

59. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

60. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon të jetë viktimë e shkeljes kushtetuese, për shkak të mosekzekutimit të vendimit të një autoriteti publik, gjegjësisht KPMSHCK-së. Prandaj, ai është palë e autorizuar.

61. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj dhe në mungesë të ndonjë mjeti tjetër efektiv në dispozicion, për të mbrojtur të drejtat e tij, ai i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

62. Gjykata po ashtu u referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

63. Gjykata vëren se vendimi i fundit në këtë procedurë është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, [Ac.nr. 3983/2018], i 24 majit 2019, të cilin parashtruesi e ka pranuar me 28 qershor 2019 dhe kërkesa është

dorëzuar në Gjykatë më 30 shtator 2019. Rezulton se kërkesa është dorëzuar në pajtim me afatin ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

64. Gjykata po ashtu konsideron se parashtruesi i kërkesës ka treguar saktësisht se cilat të drejta, të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, pretendon se janë shkelur në dëm të tij, për shkak të mospërmbarimit të Vendimit të KPMSHCK-së, nr.739, të 18 prillit 2006.

65. Prandaj, Gjykata vjen në përfundim se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike; se e ka respektuar kushtin e dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor; i ka sqaruar me saktësi shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe ka treguar cili është akti konkret i autoritetit publik që kontestohet.

66. Për më tepër, në dritën e pretendimeve të kërkesës dhe argumentimit të tyre, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze kushtetuese dhe adresimi i tyre varet nga shqyrtimi i meritave të kërkesës. Po ashtu, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar, brenda kuptimit të rregullit 39 të Rregullores së punës, si dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme.

67. Rrjedhimisht, Gjykata e shpall kërkesën të pranueshme për shqyrtim të meritave të saj.

Meritat e Kërkesës

68. Gjykata fillimisht rikujton se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës nga Komuna e Malishevës dhe me mos përmbarimin e Vendimit të KPMSHCK-së, [nr. 738], të 18 prillit 2006 i cili kishte obliguar Komunën e Malishevës që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e punës. Përmes padisë së tij, parashtruesi i kërkesës pretendoi para Gjykatës Komunale në Malisheve mosekzekutim të Vendimit të KPMSHCK-së nga Komuna e Malishevës për rikthimin e tij në vendin e punës. Gjykata Komunale në Malishevë përmes Aktgjykimit [C.nr.166/2007] e aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e cila kishte të bënte me pagesën e të ardhurave personale të humbura për periudhën kohore derisa kontrata e punës ka qenë valide, ndërsa e refuzoi pjesën e kërkesëpadisë që kishte të bëjë me kthim në vendin e tij të punës pas skadimit të vlefshmërisë së kontratës së punës për parashtruesin e kërkesë. Gjykata e Apelit, pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, përmes Aktgjykimit [Ac.nr.2942/2012] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.166/2007] e Gjykatës Komunale në Malishevë. Sipas Gjykatës se

Apelit kontrata e punës se parashtruesit të kërkesës tashmë kishte skaduar dhe se nuk do të ishte ligjore dhe e logjikshme të urdhërohet që parashtruesi i kërkesës të kthehet në vendin e punës duke qenë se kontrata e lidhur kishte fuqi ligjore vetëm deri më 31 mars 2006. Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr. 6/2014] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se Vendimi i KPMSHCK-së paraqet vendim administrativ të formës se prerë, dhe si i tillë duhet të përmbarohet nga gjykata kompetente. Pas kthimit të rastit në shkallë të parë në rigjykim, Gjykata Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë përmes Aktvendimit [Cp.nr.490/2014] detyroi Komunën e Malishevës që ta kompensojë parashtruesin e kërkesës në emër të pagave mujore në vlerë prej 934.78 euro, por refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale pas skadimit të kontratës. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3536/15] vlerësoi se Aktvendimi [Cp.nr.490/2014] i Gjykatës Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë është nxjerrë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Parashtruesi i kërkesës bëri precizimin e saktë të propozimit për përmbarim të Vendimit të KPMSHCK-së pranë Gjykatës Themelore. Më 26 maj 2017, Gjykata Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë përmes Aktvendimit [Cp.nr.157/2016]: (i) aprovoi propozimin e parashtruesit të kërkesës; (ii) e detyroi Komunën e Malishevës që në bazë të vendimit të KPMSHCK-së, parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e punës; (iii) e detyroi Komunën e Malishevës që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë shpenzimet procedurale. Pas ankesës se Komunës se Malishevës, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.4085/17] anuloi Aktvendimin [Cp.nr.157/2016] e Gjykatës Themelore në Gjakovë – dega në Malishevë dhe e ktheu çështjen në shkallë të parë për riprocedim të serishëm. Gjykata Themelore në Gjakovë – dega në Malishevë, në riprocedurë përmes Aktvendimit [Cp.nr.118/2018] ia njohu parashtruesit të kërkesës vetëm të drejtën e kompensimit të të ardhurave financiare dhe atë vetëm për periudhën deri sa e ka pasur kontratën. Pas ankesës se parashtruesit, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3983/2018] vërtetoi Aktvendimin [Cp.nr.118/2018] e Gjykatës Themelore të 2 korrikut 2018. Ndërsa, Vendimi i KPMSHCK-së [nr. 738] i 18 prillit 2006, përmes së cilit ishte përcaktuar rikthimi i parashtruesit të kërkesës në vendin e punës, në tërësinë e tij nuk ishte përmbaruar asnjëherë nga Komuna e Malishevës.

69. Prandaj, pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës në rastin konkret është shkelja e të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si rezultat i

mospërmbarimit të Vendimit të KPMSHCK-së, [nr. 738], të 18 prillit 2006, nga debitori Komuna e Malishevës.

70. Rrjedhimisht, në shqyrtimin e meritave të kërkesës, Gjykata vë në pah se kërkesa e parashtruesit të kërkesës ngre dy çështje themelore: (i) nëse Vendimi i KPMSHCK-së në rastin konkret ka qenë detyrues dhe i ekzekutueshëm; dhe, (ii) nëse mospërmbarimi i Vendimit të KPMSHCK-së ka shkaktuar shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës).

(i) nëse Vendimi i KPMSHCK-së në rastin konkret ka qenë detyrues dhe i ekzekutueshëm

71. Përkitazi me natyrën juridike të vendimeve të KPMSHCK-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme që fillimisht t'i referohet nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës, që përcakton:

> *"1. Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.*
>
> *2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës."*

72. Në dritën e këtyre dispozitave kushtetuese, Gjykata thekson qëndrimin e saj parimor se KPMSHCK-ja është institucion i pavarur i themeluar me Kushtetutë, gjegjësisht në pajtim me nenin 101. 2 të Kushtetutës. Prandaj, të gjitha detyrimet që dalin nga vendimet e këtij institucioni, lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e tij, prodhojnë efekte juridike për të gjitha institucionet përkatëse, ku statusi i të punësuarve rregullohet me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim, KPMSHCK-ja ka tiparet e një gjykate, gjegjësisht tribunali për shërbyesit civilë, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastet e Gjykatës KI193/18, parashtrues *Agron Vula*, Aktgjykim i 12 majit 2020, paragrafi 100; dhe KI33/16, parashtruese *Minire Zeka*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 54)

73. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas së cilës *"'gjykata' karakterizohet në kuptimin thelbësor të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë vendosja e çështjeve brenda kompetencave të saj në bazë të rregullave të së drejtës dhe pas procedurave të kryera në mënyrë të paraparë"* (shih rastet e Gjykatës KI193/18, parashtrues *Agron Vula*,

të cituar më lart, paragrafi 101; dhe KI33/16, parashtruese *Minire Zeka*, të cituar më lart, paragrafi 55; si dhe rastet e GJEDNJ-së, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987 në çështjen *H kundër Belgjikës*, Seria A. nr. 127, f. 34, paragrafi 50; shih po ashtu rastin e GJEDNJ-së *Belilos kundër Zvicrës*, ankesë nr. 10328/83, Aktgjykimi i 29 prillit 1988, paragrafi 64).

74. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Vendimi i KPMSHCK-së, [nr. 738], i 18 prillit 2006 ishte nxjerrë në kohën kur themelimi i KPMSHCK-së dhe përmbarimi i vendimeve të saj ishte rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Urdhëresën Administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, që kishin hyrë në fuqi më 22 dhjetor 2001, gjegjësisht më 25 janar 2003. Atëbotë, çështja e kompetencave, funksionimit, organizimit dhe zbatimit të vendimeve të KPMSHCK-së ishte rregulluar me akte të nxjerra nga UNMIK-u (që kishte kompetenca ekskluzive legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në Kosovë).

75. Në këtë drejtim, Gjykata thekson qëndrimin e saj konsekuent që e ka mbajtur në të gjitha rastet e vendosura prej saj, që kanë pasur të bëjnë me vendimet e KPMSHCK-së, që nga viti 2012 e këndej. Gjykata në vazhdimësi ka vënë në pah se një vendim i KPMSHCK-së prodhon efekte juridike për palët dhe, për këtë arsye, një vendim i tillë është vendim i formës së prerë në procedurë administrative dhe i përmbarueshëm (shih vendimet e Gjykatës në rastet KI04/12 *Esat Kelmendi*, Aktgjykimi i 24 korrikut 2012 dhe nr. KI74/12, *Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 prillit 2015 dhe referencat e cituara aty; si dhe rastet KI193/18, parashtrues *Agron Vula*, të cituar më lart, paragrafi 103; dhe KI33/16, parashtruese *Minire Zeka*, të cituar më lart, paragrafi 57).

76. Gjykata sjell në vëmendje se ndër rastet e para ku ishte konstatuar se vendimet e KMPSHCK-së janë të formës së prerë dhe të detyrueshme për përmbarim është Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI04/12, i 24 korrikut 2012. Në aktgjykimin në fjalë, Gjykata kishte trajtuar efektin e Vendimit të KPMSHCK-së të datës 18 mars 2011 – që do të thotë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për KPMSHCK-në Nr.03/L-192, i cili më vonë, më 10 gusht 2018, u zëvendësua dhe u shfuqizua nga Ligji për KPMSHCK-në, Nr. 06/L-048. Që të dy ligjet në fjalë, janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

77. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore, përveç kompetencës lëndore të KPMSHCK-së për të zgjidhur mosmarrëveshjet e punës për nëpunësit civilë, paraqesin

detyrim ligjor për institucionet gjegjëse për të respektuar dhe zbatuar vendimet e KPMSHCK-së (shih rastet e Gjykatës KI193/18, parashtrues *Agron Vula*, të cituar më lart, paragrafi 101; dhe KI33/16, parashtruese *Minire Zeka*, të cituar më lart, paragrafi 58).

78. Në këtë vazhdë, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore edhe lidhur me mospërmbarimin nga ana e gjykatave të vendimeve administrative – duke përfshirë edhe vendimet e KPMSHCK-së – të cilat nuk kanë parashikuar në mënyrë ekskluzive një detyrim në të holla (shih, ndër të tjera, vendimet e Gjykatës në rastet: KI94/13, parashtrues *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 16 prillit 2014; KI112/12, parashtrues *Adem Meta*, Aktgjykim i 2 gushtit 2018 dhe KI04/12, parashtrues *Esat Kelmendi*, cituar më lart, Aktgjykim i 24 korrikut 2012). Në këto raste, Gjykata erdhi në përfundim se një vendim i nxjerrë nga një organ administrativ, i themeluar me ligj, prodhon efekte juridike për palët dhe, rrjedhimisht një vendim i tillë është një vendim administrativ i formës së prerë dhe i përmbarueshëm" (shih po ashtu rastin e Gjykatës KI193/18, parashtrues *Agron Vula*, të cituar më lart, paragrafi 106).

79. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Vendimi i KPMSHCK-së është i 18 prillit 2006. Por, Gjykata po ashtu vëren se ai vendim kishte mbetur objekt i procedurave gjyqësore, që nga viti 2011 deri në vitin 2019.

80. Për më tepër, duke u mbështetur në shkresat e lëndës që ka në dispozicion, Gjykata thekson posaçërisht faktin se Vendimi i KPMSHCK-së ishte vërtetuar nga Gjykata Supreme, si shkallë e fundit, përmes Aktvendimit [Rev.nr.6/2014] të 7 marsit 2014, e cila kishte konstatuar se *"Vendimi i lartpërmendur i KPMSHCK-së paraqet vendim administrativ të formës se prerë, dhe si i tillë duhet të përmbarohet nga gjykata kompetente sipas propozimit për përmbarim nga kreditori në kuptim të realizmit të së drejtës së fituar në procedurë administrative"*.

81. Gjykata konsideron se trajtimi për më shumë se 6 vite në procedura gjyqësore, i Vendimit të KPMSHCK-së, të 16 prillit 2006 dhe, sidomos, vërtetimi i karakterit detyrues të tij nga gjykatat e rregullta, kanë bërë që vendimi në fjalë të mos ketë karakter të atëçastshëm por të vazhdueshëm.

82. Rjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se Vendimi i KPMSHCK-së në rastin konkret ka qenë i formës së prerë dhe i detyrueshëm për t'u ekzekutuar.

(ii) nëse mospërmbarimi i Vendimit të KPMSHCK-së ka shkaktuar shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

83. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), të KEDNJ-së.

84. Në dritën e fakteve dhe pretendimeve të kërkesës, Gjykata së pari, i referohet nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], që përcakton:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."*

85. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe paragrafit 1, të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, që parasheh:

> *"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme."*

86. Gjykata po ashtu i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."*

87. Gjykata fillimisht sjellë në vëmendje se Vendimi i KPMSHCK-së [nr. 738] ka përcaktuar se Komuna e Malishevës duhet ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e punës, më të gjitha të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës nga data e largimit.

88. Gjykata verën se përmbarimi i Vendimit të KPMSHCK-së ka pasur direkt të bëjë me kthimin e parashtruesit të kërkesës në vendin e punës dhe jo vetëm me çështjen e kompensimit financiar në emër të pagave të papaguara gjatë periudhës se largimit nga puna.

89. Më tutje, duke u mbështetur në shkresat e lëndës që ajo posedon, Gjykata vëren se përkundër përpjekjeve të pareshtura të parashtruesit të kërkesës që Vendimi i KPMSHCK-së të përmbarohet, ai vendim nuk është zbatuar asnjëherë dhe as nuk është shfuqizuar. Pra, kanë kaluar më tepër se 12 (dymbëdhjetë) vite nga nxjerrja e Vendimit të KPMSHCK-së (18 prill 2006) deri në vendimin e fundit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 3983/2018], të 24 majit 2019.

90. Në dritën e këtyre fakteve, Gjykata vë në pah pretendimin kryesor të parashtruesit, përkitazi me cenimin e të drejtës së tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet aktgjykimit të saj në rastin nr. KI94/13, ku kishte theksuar se *"përmbarimi i vendimit të prerë dhe të përmbaruesshëm duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së*" (shih Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI94/13, parashtrues, *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 16 prillit 2014; si dhe rastin KI193/18, parashtrues A*gron Vula*, të cituar më lart, paragrafi 106).

91. Gjykata vëren se një qëndrim i tillë mbështetet dhe në praktikën e GJEDNJ-së, e cila thekson se përmbarimi i një vendimi të formës së prerë duhet shikuar si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë. Për më tepër, në rastin *Hornsby kundër Greqisë*, GJEDNJ ka vënë në pah se përmbarimi i vendimit të formës së prerë është i një rëndësie edhe më të madhe në kuadër të procedurës administrative në lidhje me një kontest, rezultati i të cilit është i një rëndësie të posaçme për të drejtat civile të palës në kontest (*Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, Aktgjykim i 19 marsit 1997, paragrafët 40-41). Në rastin në fjalë, GJEDNJ konstatoi se parashtruesit e kërkesës nuk do të duhej të ishin privuar nga përfitimi i përmbarimit të vendimit të formës së prerë, që ishte marrë në dobi të tyre.

92. Prandaj, Gjykata thekson se zbatimi i një vendimi të formës së prerë dhe të detyrueshëm, brenda një afati të arsyeshëm, është e drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

93. Në lidhje më këtë, Gjykata vëren se GJEDNJ-ja në praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore ka konstatuar se duke u shmangur për më shumë se 5 (pesë) vite për ndërmarrjen e masave të nevojshme për zbatim të një vendimi të formës së prerë dhe të detyrueshëm, autoritetet shtetërore kishin zhveshur dispozitat e nenit 6 nga tërë efekti i tyre i dobishëm (Shih *Hornsby kundër Greqisë*, paragrafi 45).

94. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se mosmarrëveshja e parashtruesit të kërkesës me Komunën e Malishevës nuk ka qenë posaçërisht e ndërlikuar, sepse KPMSHCK-ja kishte urdhëruar kthimin e parashtruesit të kërkesës në vendin e punës, në pajtim me ligjin në fuqi. Vendimi i KPMSHCK-së ka mbetur i pazbatuar nga Komuna e Malishevës edhe sot e kësaj dite.

95. Gjykata merr në konsideratë disa nga arsyetimet e gjykatave të rregullta se, duke qenë që kontrata e parashtruesit të kërkesës ishte në kohë të caktuar deri me 31 mars 2006, rrjedhimisht sipas tyre kishte skaduar tashmë kohëzgjatja e kontratës së punës, ndaj tij është aprovuar vetëm kompensimi financiar nga data e largimit nga puna por jo edhe rikthimi në vendin e punës ashtu siç e përcaktonte Vendimi i KPMSHCK-së, i 18 prillit 2006.

96. Sidoqoftë, Gjykata vë theksin në konstatimin e dhënë në Vendimin e KMPSHCK-së, se suspendimi i parashtruesit nga vendi i punës, nga ana e Komunës së Malishevës, ishte bërë në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore në fuqi. Prandaj, efekti i vendimit joligjor të Komunës së Malishevës (i vitit 2005), për largimin e parashtruesit të kërkesës nga vendi i tij i punës, do duhej të sanohej duke u zbatuar Vendimi i KPMSHCK-së. Aq më tepër kur përmbarueshmëria e Vendimit të KPMSHCK-së është konfirmuar me dy aktvendime të gjykatave të rregullta, përkatësisht përmes Aktvendimit [Cp.nr.157/2016] të 26 majit 2017, të Gjykatës Themelore në Gjakovë – dega në Malishevë dhe përmes Aktvendimit [Rev.nr. 6/2014], të 7 Marsit 2017, të Gjykatës Supreme.

97. Në ndërlidhje më këtë, Gjykata thekson se do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi juridik i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim i formës së prerë në procedurë administrative dhe i përmbarueshëm, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Prandaj, joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat sjellin para situatave që janë në shpërputhje me parimin e sundimit të ligjit (neni 7 i Kushtetutës) – parim ky të cilin të gjitha autoritetet publike në Kosovë janë të detyruara ta respektojnë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin KI04/12; dhe KI193/18, parashtrues *Agron Vula,* të cituar më lart,

paragrafi 126; dhe KI33/16, parashtruese *Minire Zeka*, të cituar më lart, paragrafi 66).

98. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në bazë të pohimeve të parashtruesit në kërkesë, duke kërkuar përmbarimin e Vendimit të KPMSHCK-së, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar Komunës së Malishevës dhe disa herë gjykatave të rregullta. Për më tepër, Gjykata rithekson se, gjykatat e rregullta (të shkallës së parë dhe të dytë), kanë nxjerrë dy vendime në dobi të parashtruesit të kërkesës – që lejuan përmbarimin e Vendimit të KPMSHCK-së – dhe disa vendime të kundërta.

99. Pra, parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, për përmbarimin e Vendimit të KPMSHCK-së. Megjithatë, pavarësisht përpjekjes së tij, ai Vendim nuk është përmbaruar, as nga organet kompetente të Komunës së Malishevës dhe as nga gjykatat kompetente.

100. Bazuar në të lartcekura, Gjykata Konstaton se dështimi për të përmbaruar një vendimi përfundimtar dhe të detyrueshme të KPMSHCK-së përben shkelje të se drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetues dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Përfundim

101. Gjykata Kushtetuese vë në pah detyrimin e saj kushtetues që të sigurojë që procedurat që zhvillohen para autoriteteve publike, sidomos para gjykatave, duhet të respektojnë të drejtat themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

102. Në rrethanat e rastit konkret Gjykata konstaton se mospërmbarimi i Vendimit të KPMSHCK-së, nr. 738, i 18 prillit 2006, nga Komuna e Malishevës dhe gjykatat e rregullta për një periudhe kohore kaq të gjatë që nga nxjerrja e Vendimit të KPMSHCK-së, për kthimin e parashtruesit të kërkesës në pozitën e tij të mëparshme përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së. Si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtruesi i kërkesës ishte privuar nga e drejta e tij për t'u rikthyer në vendin e punës në pajtim me urdhrin e Vendimit të KPMSHCK-së të nxjerrë në favor të tij.

103. Gjykata konstaton se fakti se Vendimi i KPMSHCK-së i nxjerrë në favor të parashtruesit të kërkesës nuk u ekzekutua nga gjykatat e rregullta dhe Komuna e Malishevës që nga viti 2006 e tutje, ka

rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe mosrespektim të procedurave kushtetuese.

104. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata thekson se, mbështetur në jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ-së, sa herë që konstatohet shkelje e të drejtës për gjykim të drejtë nga neni 6 i KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës, për aq sa është e mundur, duhet të vihet në pozitë që të gëzojë të drejtat që ai do t'i kishte pasur nëse procedurat do ishin zhvilluar në pajtim me garancitë e KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, *Kingsley kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Aktgjykim i 28 majit 2002, paragrafi 40 dhe referencat e përmendura aty).

105. Si përmbledhje, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, Vendimi i KPMSHCK-së nr.738, i 18 prillit 2006 duhet të zbatohet nga Komuna e Malishevës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 59 (1) dhe 66 të Rregullores së punës, më 1 korrik 2021,

VENDOS

I. TË SHPALLË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, njëzëri, se mospërmbarimi i Vendimit të KPMSHCK-së, nr. 738, i 18 prillit 2006, ka shkaktuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së;

III. TË SHPALLË, më shumicë votash, të pavlefshëm Aktvendimin [Ac.nr.3983/2018] e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, të 24 majit 2019, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë [C.nr.118/2018] të 2 korrikut 2018.

IV. TË URDHËROJË Komunën e Malishevës ta zbatojë Vendimin e KPMSHCK-së nr. 738, të 18 prillit 2006, të nxjerrë në dobi të parashtruesit të kërkesës, në përputhje me *ratio decidendi* të këtij Aktgjykimi;

V. TË URDHEROJË Komunën e Malishevës që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores se

punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës deri me 20 dhjetor 2021;

VI. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me atë urdhër;

VII. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;

VIII. TË SHPALLË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtare raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Remzije Istrefi-Peci	Gresa Caka-Nimani

KI167/20 dhe KI170/20, Parashtrues: *Tasim Zhuniqi dhe Nasip Zhuniqi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 344/2019, të 2 qershorit 2020

KI167/20 dhe KI170/20, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 korrikut 2021, publikuar më 17 gusht 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, ricilësim i veprës penale, kërkesë e papranueshme, kërkesë qartazi e pabazuar, mosshterim i mjeteve juridike*

Nga shkresat e lëndës rezulton se ndaj parashtruesve të kërkesës, më 27 mars 2017 Prokuroria Themelore në Gjakovë kishte ngritur Aktakuzën [PP/I. nr. n38/2016] nën dyshimin e bazuar se: (i) ata më 26 mars 2016 në bashkëkryerje kishin kryer veprën penale të "vrasjes" nga neni 178 në lidhje me nenin 31 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK) duke privuar nga jeta të ndjerin N. K. (ii) kishin kryer veprën penale "mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së; dhe në vijim; dhe se (iii) parashtruesi i kërkesës në rastin KI170/20 gjithashtu kishte kryer veprat penale të "shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm" nga neni 365, paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së. Më 3 maj 2017, Prokuroria Themelore, në Gjykatën Themelore kishte dorëzuar Aktakuzën e ndryshuar të bazuar në Udhëzimin e detyrueshëm të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit [NA. nr. 140/2017] të 19 prillit 2017, përmes të cilit ishte kërkuar ricilësimi i veprës penale të "vrasjes" në bashkëkryerje në veprën penale e "vrasjes së rëndë" në bashkëkryerje nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4 dhe 1.5 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Çështja e ricilësimit të veprës penale ishte ngritur si në kuadër të procedurës për hedhjen poshtë të aktakuzës ashtu edhe në procedurën e shqyrtimit gjyqësor. Në procedurë të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kishin konstatuar se ky pretendim ishte shqyrtuar në procedurën e shqyrtimit të dytë, respektivisht procedurën e hedhjes së Aktakuzës përmes aktvendimeve PKR. nr. 36/2017, të 5 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore dhe Aktvendimit PN. nr. 520/2017, të 6 korrikut 2017 të Gjykatës së Apelit. Megjithatë, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj të kontestuar kishte adresuar dhe elaboruar të njëjtin pretendim të ngritur në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe për pasojë, kishte ofruar konstatim përkitazi me bazueshmërinë e pretendimit të tyre për ricëilësim të veprës penale duke theksuar se "*ndryshimi i aktakuzës me ricilësim të veprës penale nga vrasje në bashkëkryerje në vrasje të rëndë në bashkëkryerje nuk është bërë në mënyrë të kundërligjshme dhe se me asnjë dispozitë ligjore nuk i ndalohet Prokurorit që ta ndryshojë akuzën para shqyrtimit fillestar.*"

Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës; (i) kontestojnë çështjen e ricilësimit të veprës penale; përderisa parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 pretendoi edhe: (ii) mungesë të paanshmërisë nga ana e gjykatave të rregullta; (iii) dhe se gjykatat e rregullta nuk i kanë marrë parasysh vërejtjet e dhëna përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 256/2018, të 29 qershorit 2018 të Gjykatës së Apelit. Parashtruesit e kërkesës pretendimet e lartcekura i ngritin në kuptim të shkeljes së nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], nenit 102 dhe nenit 109 të Kushtetutës.

Fillimisht, sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 102 dhe 109 të Kushtetutës, Gjykata vuri në dukje qëndrimin e saj të përgjithshëm se nenet e Kushtetutës të cilat nuk përcaktojnë, drejtpërdrejtë, të drejtat dhe liritë themelore nuk kanë efekt të pavarur. Efekti i tyre vlen vetëm për "gëzimin e të drejtave dhe lirive" që garantohen me dispozitat e Kapitullit II [Të drejtat dhe Liritë Themelore] dhe III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës. Në kuptim të kësaj, Gjykata theksoi se, në thelb, pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me nenet 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës, ndërlidhen me shkeljen e pretenduar të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës.

Së pari, përkitazi me ricilësimin e veprës penale, Gjykata konsideroi se kërkesat e parashtruesve të kërkesës janë të papranueshme. Në këtë kuptim, Gjykata vuri në pah se parashtruesve të kërkesës iu është mundësuar zhvillimi i dy procedurave penale, përkatësisht procedurës së hedhjes së aktakuzës dhe procedurës së shqyrtimit gjyqësor bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se atyre iu është dhënë mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë të rëndësishme për rastin e tyre; se atyre iu është dhënë mundësia që të kontestojnë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta . Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes nenit 47 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Së dyti, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20 përkitazi me mungesë të paanshmërinë së gjykatave të rregullta, Gjykata konstatoi se këtë pretendim, parashtruesi nuk e kishte ngritur para gjykatave të rregullt, dhe rrjedhimisht e shpalli si të papranueshme për shkak të mosshterimit substancial të mjeteve juridike në pajtim me paragrafin 1 dhe

7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit, dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Në fund, përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20 për mos marrjen parasysh të vërejtjeve të dhëna përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 256/2018, të 29 qershorit 2018 të Gjykatës së Apelit nga gjykatat e rregullta gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata konstatoi se ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes nenit 47 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI167/20 dhe KI170/20

Parashtrues

Tasim Zhuniqi dhe Nasip Zhuniqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 344/2019, të 2 qershorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI167/20 është dorëzuar nga Tasim Zhuniqi, të cilin e përfaqëson Myrvete Çollaku, avokate në Prizren (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20).

2. Kërkesa KI170/20 është dorëzuar nga Nasip Zhuniqi, të cilin e përfaqëson Kosovare Kelmendi, avokate në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës në rastin KI170/20).

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesave kontestojnë Aktgjykimin Pml. nr. 344/2019, të 2 qershorit 2020, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin PAKR. nr. 393/2019, të 20 shtatorit 2019, të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin PKR. nr. 41/18, të 18 qershorit 2019 të Gjykatës Themelore në

Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

4. Parashtruesit e kërkesës, Aktgjykimin e kontestuar e kanë pranuar më 22 korrik 2020.

Objekti i çështjes

5. Objekti i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit parashtruesit e kërkesës pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; si dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe nenin 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

6. Kërkesat bazohen në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe rregullin 40 [Bashkimi dhe ndarja e kërkesave] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 29 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 2 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.

9. Më 5 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës në rastin KI170/20 e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

10. Më 17 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI170/20 me kërkesën KI167/20.

11. Më 18 nëntor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesës KI167/29 me kërkesën KI170/20, si dhe u kërkoi përfaqësueseve ligjore të parashtruesve të kërkesës (i) që të dorëzojnë autorizimet për përfaqësim në Gjykatën Kushtetuese, dhe (ii) të gjitha ankesat e tyre, parashtruar në gjykatat e rregullta.

12. Më 30 nëntor 2020, përfaqësuesja ligjore e parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20 dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë.

13. Më 1 dhjetor 2020, përfaqësuesja ligjore e parashtruesit të kërkesës në rastin KI170/20 dorëzoi dokumente shtesë.

14. Më 11 dhjetor 2020, përfaqësuesja ligjore e parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20 sërish i dorëzoi Gjykatës dokumente shtesë.

15. Më 24 dhjetor 2020, Gjykata sërish kërkoi nga përfaqësueset ligjore të parashtruesve të kërkesës dorëzimin e autorizimeve të vlefshme për përfaqësim në Gjykatë.

16. Më 8 janar 2021, përfaqësueset ligjore të parashtruesve të kërkesës dorëzuan veç e veç autorizimet për përfaqësim të parashtruesve të kërkesës, të kërkuara nga Gjykata.

17. Më 19 shkurt, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesës KI167/29 me kërkesën KI170/20. Po të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Themelore kërkesën për dorëzimin e fletëkthesës, e cila dëshmon se kur parashtruesit e kërkesës kanë pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

18. Më 26 shkurt 2021, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesat, të cilat dëshmojnë se parashtruesit e kërkesës, respektivisht përfaqësueset ligjore të tyre, Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e kanë pranuar më 22 korrik 2020.

19. Më 29 mars 2021, Gjykata i dërgoi Gjykatës Themelore kërkesën për dorëzimin e dosjes së plotë të rastit.

20. Më 8 prill 2021, Gjykata pranoi dosjen e plotë të rastit të dorëzuar nga Gjykata Themelore.

21. Më 12 maj 2021, Gjykata i ktheu dosjen e plotë të rastit Gjykatës Themelore.

22. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

23. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

24. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KK160/21, përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohet kryesuese në Kolegje shqyrtuese në rastet ku është caktuar si anëtare e Kolegjit, duke përfshirë rastin aktual.

25. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

26. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin KSH.KI167/20 për caktimin e gjyqtares Selvete Gërxhaliu-Krasniqi si anëtare në Kolegjin Shqyrtues në vend të gjyqtares Arta Rama-Hajrizi, kryetare.

27. Më 21 korrik 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

28. Më 27 mars 2017, Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Prokuroria Themelore) ngriti Aktakuzën [PP/I. nr. n38/2016] ndaj parashtruesve të kërkesës nën dyshimin e bazuar se:

(i) Të dy parashtruesit e kërkesës më 26 mars 2016 në bashkëkryerje kishin kryer veprën penale të "vrasjes" nga neni 178 në lidhje me nenin 31 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK), duke privuar nga jeta të ndjerin N. K.;
(ii) Parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 gjithashtu kishte kryer veprën penale "mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së;
(iii) Parashtruesi i kërkesës në rastin KI170/20 gjithashtu kishte kryer veprat penale të "shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm" nga neni 365, paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së dhe të "mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së.

29. Më 3 maj 2017, Prokuroria Themelore, në Gjykatën Themelore kishte dorëzuar Aktakuzën e ndryshuar të bazuar në Udhëzimin e detyrueshëm të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit [NA. nr. 140/2017] të 19 prillit 2017 (në tekstin e mëtejmë: Udhëzimi i Detyrueshëm, i 19 prillit 2017), përmes të cilit ishte kërkuar ricilësimi i veprës penale të "vrasjes" në bashkëkryerje në veprën penale e "vrasjes së rëndë" në bashkëkryerje nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4 dhe 1.5 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

30. Më 4 maj 2017, Gjykata Themelore kishte mbajtur seancën e parë të shqyrtimit fillestar. Sipas procesverbalit të shqyrtimit fillestar, Kryetari i trupit gjykues, palëve në procedurë iu dorëzoi aktakuzën e "përmirësuar me ricilësim të veprës penale". Në vijim, pas pyetjes së Kryetarit të trupit gjykues, nëse parashtruesit e kërkesës i kanë pranuar kopjet e Aktakuzës së 27 marsit 2017 dhe Aktakuzës së ndryshuar me ricilësimin e veprës penale, parashtruesit e kërkesës dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë deklaruan se kishin pranuar kopjet e aktakuzave të lartcekura.

31. Sipas procesverbalit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 u deklarua se pranon fajësinë në lidhje me kryerjen e veprave penale të "vrasjes së rëndë" dhe të "mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve". Parashtruesi i kërkesës në rastin KI170/20 u deklarua i pafajshëm sa i përket veprës penale "të vrasjes së rëndë" në bashkëkryerje ndërsa pranoi fajësinë përkitazi me veprën penale "mbajtje në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve".

32. Në vijim, në këtë procesverbal ishte shënuar se parashtruesve të kërkesës, në cilësinë e të akuzuarve iu ishte sqaruar: (i) natyra dhe pasoja e pranimit të fajësisë; (ii) që sipas dispozitave të KPRK-së

pranimi i fajësisë do të merret si rrethanë lehtësuese në përcaktimin e shkallës së dënimit; (iii) se me pranimin e fajësisë nuk do të ketë procedurë të provave, në të cilën të akuzuarit, përkatësisht parashtruesit e kërkesës do të kenë mundësinë e kundërshtimit të provave të aktakuzës dhe të merren prova në mbrojtje të tyre; dhe se (iv) aktgjykimi i nxjerrë në bazë të pranimit të fajësisë nuk mund të ankimohet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

33. Gjatë shqyrtimit të seancës fillestare, Prokurori i Prokurorisë Themelore kërkoi nga Kryetari i trupit gjykues që të mos e aprovojë "pranimin e fajësisë" nga parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 me arsyetimin se i njëjti akuzohet për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje dhe shtoi se për shkak të kompleksitetit të rastit është e nevojshme që të administrohet si provë edhe deklarata e këtij parashtruesi të kërkesës në cilësi të të akuzuarit.

34. Pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar, Kryetari i trupit gjykues përmes Aktvendimit vendosi: (i) që të aprovojë pranimin e fajësisë nga të dy parashtruesit e kërkesës përkitazi me veprën penale "mbajtje në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve"; dhe të (ii) refuzojë pranimin e fajësisë nga parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 për kryerjen e veprës penale të "vrasjes së rëndë" nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4 dhe 1.5 të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

Procedura për hedhje poshtë të Aktakuzës PP/I. Nr. 38/2016 të 3 majit 2017

35. Më 25 maj 2017 dhe 27 maj 2017 respektivisht, parashtruesit e kërkesës veç e veç në Gjykatën Themelore kishin dorëzuar kërkesat për (i) kundërshtimin e provave dhe (ii) hedhjes poshtë të aktakuzës PP/I. nr. 38/2016, të 3 majit 2017 përmes të cilës ishte ricilësuar vepra penale. Në kërkesat e tyre, parashtruesit e kërkesës në mënyrë specifike kishin kundërshtuar ricilësimin e veprës penale e cila ishte kërkuar përmes Udhëzimit të detyrueshëm, të 19 prillit 2017 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

36. Në një datë të paspecifikuar, Prokurori i Prokurorisë Themelore kishte dorëzuar përgjigje ndaj kërkesave të parashtruesve të kërkesës.

37. Më 5 qershor 2017, Gjykata Themelore pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit të dytë, përmes Aktvendimit PKR. nr. 36/2017 refuzoi si të pabazuara kërkesat e parashtruesve të kërkesës për (i) hedhjen poshtë

të aktakuzës; (ii) pushimin e procedurës penale dhe (iii) mosdëgjimin e dëshmitarit të mbrojtur.

38. Gjykata Themelore vlerësoi se *"dispozitivi i aktakuzës dhe përshkrimi i veprimeve është ashtu që të akuzuarit në aktakuzë PP/I. nr. 38/2016, të dt. 03.05.2017, i përgjigjet në tërësi ekzistimit të elementeve të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179, parag. 1 pika 1.4 dhe 1.5 si bashkëkryes lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, parag. 1 të KPRK-së, për çka aktakuza është e mbështetur konform dispozitave ligjore, e kjo shihet nga provat e siguruara nga ana e Prokurorisë gjatë procedurës së hetimeve, veçanërisht nga deklarata e të dëmtuarve [B.K dhe B.G], dëshmitarëve [G.Zh, E.Zh, Xh.Zh, R.K. A.K, F.E], ekspertizës së ekspertit mjeko-ligjor [F.D,] ekspertizës së ekspertit të balistikës [L.R,] raporti i shikimit të vendit të ngjarjes, raporti i ekzaminimit të veturave, lista e armëve të konfiskuara procesverbali mbi bastisjes së banesës dhe personave [...] si dhe nga provat materiale në tërësi është mbështetur dyshimi i bazuar mirë se [parashtruesit e kërkesës] kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen".*

39. Më 27 qershor 2017, kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe të ligjit penal.

40. Në ankesën e tyre, parashtruesit e kërkesës pretenduan se Aktakuza e 3 majit 2017 me ricilësimin e veprës penale bazuar në Udhëzimin e detyrueshëm, të 19 prillit 2017 ishte nxjerrë në shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 05/-034 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit (Ligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit).

41. Më 6 korrik 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit PN. nr. 520/2017, refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin PKR. nr. 36/2017, të 5 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore.

42. Gjykata e Apelit në adresimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës të paraqitura në ankesat e tyre vlerësoi se *"[...] Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar për hedhjen e aktakuzës është kujdesur sipas thënieve në kërkesë që të vlerësojë dhe në mënyrë të drejtë ka dhënë arsye të mjaftueshme se aktakuza e ngritur dhe e ricilësuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka prova të mjaftueshme se për të mbështetur dyshimin e bazuar se të akuzuarit*

kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen e ku të gjitha këto prova edhe janë cekur në aktakuzën e ngritur e po ashtu janë cekur edhe në aktvendimin e ankimuar, dhe në ankesë nuk është paraqitur asnjë bazë ligjore për të cilën mund të hedhet aktakuza, ashtu siç kërkohet me dispozitat e nenit 250, par. 1, nënpar. 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPPK-së, po ashtu nga veprimet e përshkruara në aktakuzë, tani për tani eksiztojnë elementet qenësore të veprave penale për të cilat janë akuzuar [parashtruesit e kërkesës], dhe se nga provat të cilat i ka propozuar prokurori për lexim gjatë shqyrtimit gjyqësor në të cilat prova edhe e ka mbështetur dyshimin e bazuar me rastin e ngritjes së aktakuzës dhe plotësimin e saj do të vlerësohen në shqyrtimin gjyqësor. Po ashtu në ankesë [parashtruesit e kërkesës] në ankesat e tyre nuk kanë cekur asnjë rrethanë se në çfarë provash mbështesin pretendimet e tyre, por vetëm kanë bërë kundërshtimin e aktakuzës në mënyrë gjenerale pa specifikuar asnjë rrethanë apo provë konkrete që do të mbështeste pretendimin e tyre për hedhjen e aktakuzës. Procedura penale tani është në fazën pas ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit rreth saj, ndërsa përgjegjësia penalo-juridike e [parashtruesve të kërkesës] do të vlerësohet gjatë shqyrtimit kryesor me nxjerrjen dhe shpalljen e provave, e në kuadër të kësaj edhe të vlerësimit të provave nga ana e gjykatës e që në këto faza të procedurës penale, fajësia nuk mund të supozohet as nga Gjykata, e as nga palët".

Procedura e shqyrtimit gjyqësor

43. Më 16 mars 2018, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit PKR. nr. 36/2017:

    I. Konstatoi se parashtruesit e kërkesës më 26 mars 2016, me dashje dhe në bashkëkryerje kishin privuar nga jeta N. K., dhe për pasojë i shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale të "vrasjes" në bashkëkryerje nga neni 178 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;

    II. Parashtruesin e kërkesës në rastin KI170/20 e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale "mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së;

    III. Parashtruesin e kërkesës në rastin KI167/20 për veprën penale "vrasje" në bashkëkryerje nga neni 178 i KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) viteve, ndërsa për veprën penale "mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të

armëve" e dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj burgim. Parashtruesit të kërkesës në rastin KI170/20 për veprën penale "vrasje" në bashkëkryerje i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 14 (katërmbëdhjetë) viteve, ndërsa për veprën penale "mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" e dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj burgim. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore bazuar në nenin 80 të KPRK-së, parashtruesin e kërkesës në rastin KI167/20 e gjykoi me dënim unik të burgimit në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) viteve, në të cilin dënim do t' i llogaritej koha e kaluar në paraburgim nga 26 marsi 2016, ndërsa parashtruesin e kërkesës në rastin KI170/20 e gjykoi me dënim unik të burgimit në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) viteve, në të cilin dënim do t' i llogaritej koha e kaluar në paraburgim nga 26 marsi 2016. Në fund, të dëmtuarit: B. K., bashkëshorten e të ndjerit N. K dhe B. G për realizmin e kërkesës pasurore-juridike i udhëzoi në kontest civil.

44. Gjykata Themelore, pas administrimit të provave dhe dëshmive të dëshmitarëve, theksoi se nuk aprovon kualifikimin juridik të veprës penale të "vrasjes së rëndë" nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4 dhe 1.5 të KPRK-së. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata Themelore konstatoi se në veprimet e parashtruesve të kërkesave ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale të vrasjes në bashkëkryerje nga neni 178 të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

45. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, në Gjykatën e Apelit, ankesa parashtruan: Prokuroria Themelore, pala e dëmtuar dhe parashtruesit e kërkesës.

46. Prokuroria Themelore në ankesën e saj pretendoi (i) shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale; (ii) vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike përkitazi me veprën penale të vrasjes në bashkëkryerje nga neni 178 i KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së; dhe paraqiti (iii) ankesë për shkak të vendimit për dënimin. Në ankesën e saj, Prokuroria Themelore propozoi që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore (i) përkitazi me veprën penale të "vrasjes" në bashkëkryerje të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje, ndërsa (ii) përkitazi me veprën penale "mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve" të ndryshohet dënimi në mënyrë që parashtruesve të kërkesave t' iu shqiptohen dënime më të ashpra.

47. Më 29 qershor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 256/2018:

    (i) Refuzoi si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore, palës së dëmtuar dhe parashtruesve të kërkesës, dhe vërtetoi Aktgjykimin PKR. nr. 36/2017, e 16 marsit 2018, të Gjykatës Themelore përkitazi me veprat penale "mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve "nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së, për secilin parashtrues veç e veç;
    (ii) Aprovoi ankesat e Prokurorisë Themelore dhe [parashtruesve të kërkesës], por edhe "sipas detyrës zyrtare" anuloi Aktgjykimin PKR. nr. 36/2017, të 16 marsit 2018, të Gjykatës Themelore përkitazi me veprën penale "vrasje" në bashkëkryerje nga neni 178 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së dhe çështjen e ktheu në rigjykim dhe rivendosje;
    (iii) Konstatoi që ankesa e palës së dëmtuar përkitazi me vendimin për dënim për veprën penale vrasje në bashkëkryerje nga neni 178 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, tani për tani mbetet jolëndore; dhe
    (iv) Vendosi që parashtruesve të kërkesës t' iu vazhdohet paraburgimi.

48. Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj vlerësoi se Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Themelore ishte nxjerrë në shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.

49. Gjykata e Apelit theksoi se në rigjykim, gjykata e shkallës së parë, respektivisht Gjykata Themelore duhet të veprojë në pajtim me vërejtjet e dhëna nga kjo gjykatë, përkatësisht: t' i eliminojë kundërthëniet në dispozitivin e Gjykatës Themelore; të procedojë edhe njëherë me të gjitha provat me qëllim të "zbardhjes së drejtë dhe të plotë të fakteve"; të marrë për bazë deklaratat e dëshmitarëve okularë në vendin e ngjarjes; të bëhet rikonstruimi i vendit të ngjarjes; pas procedimit të provave duhet që të njëjtat t' i vlerësojë në pajtim me nenin 361 të KPPRK-së; të nxirren konkluzione të drejta dhe të ligjshme që mbështeten në provat e proceduara; dhe rrjedhimisht të nxirret vendimi përkatës dhe i ligjshëm, përmes të cilit merren parasysh edhe pretendimet e tjera të cekura në ankesë.

50. Më 18 qershor 2019, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit PKR. nr. 41/18, parashtruesit e kërkesës i shpalli fajtor se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të "vrasjes së rëndë" nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së duke e privuar nga jeta të ndjerin N. K.

51. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit të saj: (i) parashtruesin e kërkesës në rastin KI167/20 e gjykoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) viteve, në të cilin dënim do të llogaritej edhe koha e kaluar në paraburgim nga 26 marsi 2016 dhe (ii) parashtruesin e kërkesës në rastin KI170/20 e gjykoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) viteve, në të cilin dënim do t' i llogaritej edhe koha e kaluar në paraburgim nga 26 marsi 2016. Ndërsa palën e dëmtuar B. K për realizmin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest civil.

52. Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj theksoi se *"ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e prokurorisë të parashtruara si në aktakuzë ashtu edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, pretendimet e palës së dëmtuar, pastaj pretendimet e mbrojtjes të parashtruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe të gjitha provat e administruara veç e veç, e pastaj të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe ka konstatuar se të akuzuarit [parashtruesit e kërkesave] në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179, par. 1, nënpar. 1.5 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPRK-së.*

53. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20 për shkelje të dispozitave ligjore, si rezultat i ricilësimit të veprës penale përmes Aktakuzës së 3 majit 2017, Gjykata Themelore konstatoi se: *" [...] ky pretendim i mbrojtjes është i pabazuar dhe nuk ka mbështetje ligjore për faktin se për këtë pretendim mbrojtja ka parashtruar kundërshtimet në shqyrtimin e dytë, e po ashtu edhe me ankesë kundër vendimit PKR. nr. 36/17 të datës 05.06.2017 të marrë në shqyrtimin e dytë, e ku edhe me vendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PN. nr. 520/2017 të datës 06.07.2017 janë refuzuar ankesat e mbrojtjes të parashtruar mbi këtë të bazë. Andaj, bazuar në faktin se për këtë pretendim është vendosur nga gjykata e instancës më të lartë, si dhe duke u bazuar edhe në dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale ku është e paraparë se prokuroria ka të drejtë të ndryshojë aktakuzën, por palëve duhet t' iu jepet e drejta që t'i paraqesin kundërshtimet e tyre, bazuar në faktin se aktakuza është ndryshuar para seancës së shqyrtimit fillestar, e të gjitha palët i kanë paraqitur kundërshtimet e tyre, e për të cilat kundërshtime është vendosur, sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim është i pabazuar dhe aktakuza është e ligjshme".*

54. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, pala e dëmtuar dhe parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesa në Gjykatën e Apelit. Parashtruesit e kërkesës në ankesat e tyre pretenduan: (i) shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale; (ii) vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes

faktike; (iii) shkelje të ligjit penal dhe (iv) parashtruan ankesë për shkak të vendimit mbi dënimin. Në ankesën e tyre, parashtruesit e kërkesës sërish kishin ngritur pretendimin e tyre përkitazi me ricilësimin e veprës penale përmes Aktakuzës së 3 majit 2017.

55. Më 20 shtator 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 393/2019 refuzoi si të pabazuara ankesat e palës së dëmtuar dhe ankesat e parashtruesve të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin PKR. nr. 41/18, e 18 qershorit 2019, të Gjykatës Themelore.

56. Gjykata e Apelit fillimisht konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës penale. Në vijim, Gjykata e Apelit, në adresimin e pretendimit të parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20 përkitazi me ricilësimin e veprës penale përmes Aktakuzës së 3 majit 2017, theksoi se: *"Lidhur me pretendimin e ngritur me shkeljet esenciale në rastin kur Prokurori i Shtetit ka bërë ricilësimin e veprës penale nga vrasja në veprën penale vrasje e rëndë, Gjykata e Apelit, gjen se ky pretendim nuk është i bazuar nga arsyeja se ankesa lidhur me këtë janë refuzuar nga Gjykata e Apelit, me Aktvendimin PN.NR. 520/17, të dt. 06.07.2017, andaj çështja ka vazhduar për veprën penale vrasje e rëndë".*

57. Ndërsa, përkitazi me pretendimet për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal, Gjykata e Apelit gjeti se: *"duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e sipërpërmendura si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajisht të theksuara në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, del se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se [parashtruesit e kërkesës] e kanë kryer veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nënpar. 1.5 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën janë shpallur fajtorë dhe se një konkludim i tillë, është i drejtë dhe se në mënyrën të padyshimtë është vërtetuar se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprime inkrimunuese për të cilat janë shpallur fajtorë. Nga këto arsye jo vetëm që nuk janë aprovuar pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, por kjo gjykatë e ka gjetur se janë të pabazuara edhe pretendimet ankimore se me aktgjykimin e ankimuar është bërë shkelja e ligjit penal në dëm të akuzuarve, ngase, është vërtetuar në mënyrë të padyshimtë fajësia e të akuzuarve, atëherë pretendimet ankimore se i akuzuari i dytë [parashtruesi i kërkesës në rastin KI170/20], nuk e ka kryer veprën penale, nuk janë të bazuara, ngase, janë në kundërshtim me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, e në të cilën janë vërtetuar se vepra penale është e kryer në bashkëkryerjeje".*

58. Në fund, përkitazi me pretendimet për vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit theksoi se me dënimet e shqiptuara nga Gjykata Themelore do të arrihet qëllimi i dënimit i përcaktuar me nenin 41 të KPRK-së.

59. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit PKR. nr. 41/2018, të 18 qershorit 2019 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit PAKR. nr. 393/2019, të 20 shtatorit 2019, parashtruesit e kërkesës veç e veç parashtruan kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme për shkak të (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe (ii) të dispozitave të ligjit penal.

60. Parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20, në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë pretendoi se: (i) Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit nuk i kanë adresuar vërejtjet e dhëna përmes Aktgjykimit të parë të Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 256/2018 të 29 qershorit 2018; dhe se (ii) me Aktakuzën e ndryshuar, të 3 majit 2017, përmes të cilës ishte ricilësuar vepra penale bazuar në Udhëzimin e detyrueshëm, të 19 prillit 2017 janë informuar në ditën e mbajtjes së shqyrtimit fillestar në Gjykatën Themelore, gjegjësisht më 4 maj 2017.

61. Parashtruesi i kërkesës në rastin KI170/20 në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë pretendoi se: (i) Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është kontradiktor dhe i paqartë; (ii) Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit nuk i kanë adresuar vërejtjet e dhëna përmes Aktgjykimit të parë të Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 256/2018 të 29 qershorit 2018; (iii) me Aktakuzën e ndryshuar, të 3 majit 2017, përmes të cilës ishte ricilësuar vepra penale dhe ishte hequr vepra penale "shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm" bazuar në Udhëzimin e detyrueshëm, të 19 prillit 2017 janë informuar në ditën e mbajtjes së shqyrtimit fillestar në Gjykatën Themelore, gjegjësisht më 4 maj 2017; dhe (iv) shkelje të ligjit penal, duke i kundërshtuar besueshmërinë e provave dhe arsyetuar se ai nuk e ka kryerën veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor.

62. Më 2 qershor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Pml. nr. 344/2019, i refuzoi si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruara nga parashtruesit e kërkesës.

63. Gjykata Supreme në adresimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës përkitazi me pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, respektivisht përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për ndryshimin e Aktakuzës [më 3 maj 2017] para seancës së shqyrtimit fillestar në Gjykatën Themelore [të mbajtur më 4 maj 2017], si rezultat i Udhëzimit të detyrueshëm, të 19 prillit 2017 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, arsyetoi si në vijim:

"Së, pari ndryshimi i aktakuzës me ricilësim të veprës penale nga vrasje në bashkëkryerje në vrasje të rëndë në bashkëkryerje nuk është bërë në mënyrë të kundërligjshme ashtu siç pa bazë pretendohet në kërkesa. Me asnjë dispozitë ligjore nuk i ndalohet Prokurorit që ta ndryshojë akuzën para shqyrtimit fillestar. Kurse fakti se një gjë e tillë është bërë sipas urdhrit të Kryeprokurorit e jo vlerësimit të Prokurorit të çështjes bie në detyrat dhe kompetencat e Prokurorit të Shtetit, [parashtruesit e kërkesës] kanë pas mundësi ta kundërshtojnë akuzën e ndryshuar, dhe çuditërisht mbrojtësja pavarësisht faktit se e konsideron si të kundërligjshme, nga procesverbali i shqyrtimit fillestar del se i dënuari Tasim [parashtruesi i kërkesës në rastin KI170/20] e ka pranuar fajësinë përkitazi me veprën penale të ricilësuar dhe mbrojtësja nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë".

64. Në vijim, përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit nuk i kanë adresuar vërejtjet e dhëna përmes Aktgjykimit të parë të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 256/2018 të 29 qershorit 2018, Gjykata Supreme arsyetoi se:

*"Së dyti, është fakt se Gjykata Themelore ka obligim ligjor të ndërmerr të gjitha veprimet procedurale dhe të shqyrtojë të gjitha çështjet kontestuese të theksuara në vendimin e Gjykatës së Apelit [*PAKR. nr. 256/2018 të 29 qershorit 2018], *mirëpo në këtë drejtim pa bazë pretendohet në kërkesa se nuk është vepruar sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, dhe ajo gjykatë në praninë e shkeljeve të njëjta e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë. Në shqyrtimin gjyqësor është proceduar sipas akuzës së ndryshuar (neni 179 të KPPRK-së) të dënuarit janë shpall fajtor për veprën penale të vrasjes (neni 178 të KPPRK-së), por këtë aktgjykim përveç; mbrojtësve të të dënuarve e ka kundërshtuar edhe prokurori sa i përket shkeljes së ligjit penal, ndërsa Gjykata e Apelit e ka kthyer çështjen në rigjykim për shkak të shkeljeve esenciale (paqartësisë së dispozitivit të aktgjykimit në raport me veprën penale për të cilën janë shpall fajtor të dënuarit - vrasjes së zakonshme) të cilat kanë qenë të ndërlidhura edhe me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për çka ajo gjykatë ka sugjeruar rikonstruimin e vendit të ngjarjes me qëllim të vërtetimit të rrethanave në të cilat është privuar nga jeta i ndjeri [N.K], sidomos vërtetimit te faktet dhe rrethanat përkitazi me reagimin e tani [N.K.] në momentin kur i akuzuari ka shtënë në [N.K.]".*

65. Në kontekst të këtij pretendimi të njëjtë, Gjykata Supreme shtoi se:

> *"Në rigjykim sipas vërejtjeve të shkallës së dytë është bërë rikonstruimi i vendit të ngjarjes dhe pas procedimit të provave tjera gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se në veprimet e [parashtruesve të kërkesës] qëndrojnë elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par. 1 pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veçanërisht në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të qarta sa i përket reagimit të ndjerit në momentin kur është shtënë në të. Gjykata e Apelit në procedurën ankimore duke vendosur përkitazi me ankesat i ka refuzuar atë si të pabazuara dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë. Nga fakti se gjykata e shkallës së parë në rigjykim pas ndërmarrjes së veprimeve sipas sugjerimeve të procedurës penale dhe procedimit të provave konkludon se në veprimet e [parashtruesve të kërkesës] përmbushen elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë për të cilën edhe janë akuzuar, nuk mund të konkludohet se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas sugjerimeve të shkallës së dytë, ngase pavarësisht obligimit ligjor për të ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe shqyrtuar çështjet kontestuese ajo pra nxjerr përfundim nëse fakti konkret është provuar respektivisht nëse është provuar përgjegjësia penale dhe elementet e veprës penale qëndron pretendimi se përderisa gjykata e shkallës së parë të [parashtruesin e kërkesës në rastin KI170/20] me aktgjykimin e kundërshtuar për veprën penale të vrasjes së rëndë e ka dënuar me 16 vite burgim ndërsa nga hyrja e arsyetimit të aktgjykimit të shkallës së dytë del se ai është dënuar me 18 vite burgim, mirëpo kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me një lëshim teknik, i cili aktgjykimin nuk e bën të pakuptueshëm, ngase nga shkresat e lëndës rezulton qartë se [parashtruesi i kërkesës në rastin KI170/20] është dënuar me 16 vite burgim, kurse ky aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit".*

66. Tutje, përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës në rastin KI170/20 se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është kontradiktor dhe i paqartë, Gjykata Supreme theksoi:

> *"Ndryshimet në përshkrimin faktik të ngjarjes në mes të dispozitivit të akuzës dhe aktgjykimit të kundërshtuar janë pasojë e provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor, e që nuk janë esenciale sepse kanë të bëjnë me përshkrimin se si është zhvilluar ngjarja pasi që i dënuari Nasip [parashtruesi i kërkesës në rastin KI170/20] ka shtënë në automjetin ku ishte i ndjeri dhe dëmtuari [B.G] dhe si është shtënë në të ndjerin nga të dy të dënuarit, por*

nuk e bëjnë aktgjykimin e paqartë ashtu siç pa bazë pretendon mbrojtësja sepse edhe nga diapozitivi i akuzës por edhe nga dispozitivi i aktgjykimit del qartë se që të dy të dënuarit kanë shtënë në të ndjerin, veprime këto që janë provuar, e që vërtetojnë edhe dashjen e tyre për ta privuar nga jeta viktimën, kurse nuk është qenësore se nga cilat të shtëna është shkaktuar pasoja apo vdekja e të ndjerit. Përveç kësaj, nga këto ndryshime nuk vjen në shprehje aplikimi i ndonjë dispozite tjetër të ligjit penal dhe as që ndryshon pozita e të dënuarve".

67. Në fund, përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me besueshmërinë e provave dhe të dëshmive të dëshmitarëve, Gjykata Supreme konstatoi se ky pretendim i referohet vërtetimit të gjendjes faktike, për të cilën nuk lejohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë. Megjithatë, Gjykata Supreme pasi vlerësoi se ky pretendim ndërlidhet edhe me pretendimin për shkelje të ligjit penal konstatoi se i njëjti është i pabazuar.

68. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se më 22 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20, përmes përfaqësueses së tij ligjore kishte parashtruar parashtresë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes të cilës kishte ngritur shqetësimet lidhur me mosdorëzimin e Udhëzimit të detyrueshëm, të 19 prillit 2017 nga Prokuroria Themelore dhe Gjykata Themelore.

69. Më 23 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20, përmes përfaqësueses së tij ligjore po ashtu kishte parashtruar kërkesë në Gjykatën Themelore, përmes të cilës kishte kërkuar që të dorëzohet kopja e Udhëzimit të detyrueshëm, të 19 prillit 2017.

70. Më 28 tetor 2020, Gjykata Themelore përmes shkresës [AGJ.I. nr. 230/20] ishte përgjigjur si në vijim: "*Gjykata Themelore Gjakovë, ju njofton se trupat gjykues kanë vendosur në të gjitha instancat gjyqësore, lidhur me të gjitha shkresat duke e përfshirë parashtresën të cilën e kërkoni ju për këtë lëndë e cila është kryer dhe arkivuar në Gjykatë*".

71. Më 13 nëntor 2020, Prokurori i Shtetit përmes njoftimit të tij, ishte përgjigjur si në vijim:

"Udhëzimi i Detyrueshëm A. nr. 140/2017 i dt. 10 prill 2017 i lëshuar nga Unë, në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit i referohet ekskluzivisht vetëm se prokurorit të shtetit [A.U], i cili është i ngarkuar për trajtim procedural penal në çështjen penale PP./I. Nr. 38/2016. Pra, i njëjti udhëzim i detyrueshëm gjatë tërë

kohës së trajtimit të këtij rasti penal nga prokurori i shtetit në fjalë, asnjë pale tjetër në këtë procedurë penale nuk i referohet dhe nuk mund të pajiset me të, ngase i njëjti paraqet akt intern në kuadër të sistemit prokurorial. Për më tej, në funksion të transparencës dhe moscenimit të parimit të barazisë së palëve në procedurë penale, Ju mund të keni vetëm qasje për shikimin e përmbajtjes së udhëzimit të sipërcekur në prezencën time, në mënyrë që në të ardhmen me rastin e ushtrimit eventual nga ana e juaj të mjeteve juridike të rregullta ashtu edhe të jashtëzakonshme kundër aktgjykimit të gjykatës kompetente lidhur me këtë çështje penale, të mund ta atakoni atë aktgjykim sipas arsyeve-bazave të parashikuara ligjore në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

A. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20

72. Parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 pretendon që Aktgjykimi [Pml. nr. 344/2019] i 2 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe në shkelje të neneve 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës.

73. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Themelore, në procedurë të rigjykimit përmes Aktgjykimit PKR. nr. 41/18, të 26 qershorit 2018 nuk i ka marrë parasysh vërejtjet e dhëna përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 256/2018, të 29 qershorit 2018. Në vijim, sipas parashtruesit të kërkesës edhe vetë Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj të dytë PAKR. nr. 393/2019 nuk kishte marrë parasysh vërejtjet e dhëna në faqen 9 dhe 10 të Aktgjykimit PAKR. nr. 256/2018, të 29 qershorit 2018 të Gjykatës së Apelit. Parashtruesi i kërkesës vazhdon me pretendimin që po të njëjtat vërejtje nuk ishin marrë parasysh as nga Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj të kontestuar.

74. Parashtruesi pretendon se *[...] në këtë çështje penale, ka pasur interferim, sikur që është evident, kontaminimi në vendin e ngjarjes, për të cilin ky procedim penal, nuk ka parë, nuk i ka kushtuar vëmendje, e ka injoruar çdo reagim të palëve".*

75. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 102 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se *"Në këtë procedim penal siç e kemi sqaruar më sipër, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, në mënyrë të pakuptimtë, gjyqtarët, në të gjitha fazat, nuk kanë qenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksionit të tyre [ka qenë e dukshme siç është sqaruar më sipër, janë dhënë detyrat nga gjykata e shkallës së dytë, për gjykatën e shkallës së parë, kjo në rigjykim nuk i ka kryer detyrat e përcaktuara në vërejtjet e gjykatës së shkallës së dytë, ka vendosur me mënyrën e vet"*. Në vijim, parashtruesi i kërkesës specifikon se edhe Gjykata e Apelit *"në ushtrimin e funksionit të saj nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme dhe vendosja e saj, procedimi i tillë, përfaqëson shkelje të paragrafit 4 të nenit 102 të Kushtetutës. E gjithashtu është shkelur edhe paragrafi 5 me të gjitha garancitë e tij"*. Në kontekst të pretendimit për mungesë të paanshmërisë dhe pavarësisë së gjyqësorit, parashtruesi i kërkesës në këtë rast pretendon edhe shkelje të nenit 32 dhe nenit 54 të Kushtetutës.

76. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 109 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se pas ngritjes së Aktakuzës nga Prokuroria Themelore [PP/I nr. 38/2016] të 27 marsit 2017, një ditë para shqyrtimit fillestar në Gjykatën Themelore, përkatësisht më 3 maj 2017 ishin informuar se si rezultat i Udhëzimit të detyrueshëm, të 19 prillit 2017, ishte kërkuar ricilësimi i veprës penale nga vepra penale vrasje në veprën penale të vrasjes së rëndë. Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson se nga Prokuroria Themelore nuk iu ishte dhënë kopje apo qasje në leximin e përmbajtjes së Udhëzimit të detyrueshëm. Rrjedhimisht, bazuar në këtë arsyetim, parashtruesi i kërkesës pretendon se të lartcekurat përbëjnë shkelje të nenit 109 të Kushtetutës.

77. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 109 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 4 të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit, përmes të cilit ishte plotësuar dhe ndryshuar neni 13, dhe në këtë aspekt citon përmbajtjen e paragrafit 7 dhe pikës 7.1 të këtij paragrafi, të cilat dispozita i referohen nxjerrjes së një Udhëzimi të detyrueshëm. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës duke iu referuar përmbajtjes së kësaj dispozite specifikon se sipas kësaj dispozite (i) kërkohet që një udhëzim i tillë duhet të jetë i arsyetuar, megjithatë palët nuk kishin qasje në përmbajtjen e tij; dhe (ii) se kjo dispozitë nuk duhet të përmbajë udhëzim për kualifikimin e veprës penale. Bazuar në këtë arsyetim parashtruesi i kërkesës pohon se "Prokurori i Shtetit nuk e ka kryer detyrën e përcaktuar ligjore", e cila, sipas tij, ka rezultuar në shkelje të nenit 109 të Kushtetutës.

78. Në fund, parashtruesi i kërkesës thekson se: *"Kjo kërkesë ka objekt konkretizimin e dispozitave të Kushtetutës së Kosovës, për palën që e përfaqësoj. Sepse dispozitat e Kushtetutës së Kosovës, i garantojnë qytetarëve të Kosovës, palëve në procedim penal: -procedim penal në bazë të ligjit; gjykim të drejtë, të paanshëm".*

B. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në rastin KI170/20

79. Parashtruesi i kërkesës në rastin KI170/20 pretendon që Aktgjykimi [Pml. nr. 344/2019] i 2 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], si dhe në shkelje të neneve 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës.

80. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i aktakuzës së ndryshuar përmes Udhëzimit të detyrueshëm, të 19 prillit 2017. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës specifikon se përmes Aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore, ai fillimisht u akuzua për veprën penale të vrasjes nga neni 178 lidhur me nenin 31 të KPRK–së, si dhe për veprat penale të "shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm" nga neni 365, paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së dhe të "armëmbajtjes pa leje" nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së. Sipas tij, pas ngritjes së aktakuzës dhe konsultimit me mbrojtjen, parashtruesi i kërkesës ishte përgatitur që të pranojë fajësinë për kryerjen e veprave penale "të shkaktimit të rrezikimit të përgjithshëm" dhe asaj të "armëmbajtjes pa leje". Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës nënvizon se si rezultat i Udhëzimit të detyrueshëm ishte hequr vepra penale e "shkaktimit të rrezikimit të përgjithshëm" dhe vepra penale e "vrasjes" ishte ricilësuar në vepër penale të "vrasjes së rëndë" nga neni 179, paragrafët 1.4 dhe 1.5. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës nënvizon faktin që me qëllim që të kuptohet arsyeja e ricilësimit të veprës penale, në shqyrtimin fillestar të mbajtur në Gjykatën Themelore kishte kërkuar kopjen e Udhëzimit të Detyrueshëm, të cilën kopje nuk e kishte pranuar asnjëherë.

81. Në kontekst të pretendimit të tij për shkelje të nenit 102 me pretendimin se *"mbrojtjes asnjëherë nuk i është dorëzuar e madje as treguar në shikim "Udhëzimi i Detyrueshëm nga Zyra e Prokurorit të Shtetit" me arsyetimin se ky Udhëzim është sekret dhe se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e ka ndaluar t'u jepet mbrojtjes apo të akuzuarve".*

82. Ndërsa, përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 109 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës citon përmbajtjen e paragrafit 2 të këtij neni, dhe thekson se kjo dispozitë është shkelur si rezultat i Udhëzimit të detyrueshëm, të 19 prillit 2017.

83. Në vijim, parashtruesi i kërkesës i referohet dhe citon përmbajtjen e paragrafit 7 dhe pikës 7.1 të nenit 13, të plotësuar dhe ndryshuar përmes nenit 4 të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit.

84. Në fund, parashtruesi i kërkesës thekson se: *"Kjo kërkesë ka objekt konkretizimin e dispozitave të Kushtetutës së Kosovës, për palën që e përfaqësoj. Sepse dispozitat e Kushtetutës së Kosovës, i garantojnë qytetarëve të Kosovës, palëve në procedim penal: -procedim penal në bazë të ligjit; gjykim të drejtë, të paanshëm".*

Dispozita relevante kushtetuese dhe ligjore

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Kapitulli
VII Sistemi i Drejtësisë

Neni 102
[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat.

2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.

3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.

4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese.

[...]

Neni 109
[Prokurori i Shtetit]

1. Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.

2. Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

NENI 6
E drejta për një proces të rregullt

1. *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

2. *Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.*

3. *Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*

   a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

   b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

   c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

   d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

   e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës

BASHKËPUNIMI NË KRYERJEN E VEPRËS PENALE

Neni 31
Bashkëkryerja

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

Neni 178
Vrasja

Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.

Neni 179
Vrasja e rëndë

1. Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili:
[...]

1.4. privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake;
1.5. privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë;

[...]

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Kosovës

Neni 26
Vendimet para shqyrtimit gjyqësor

1. Pas ngritjes së aktakuzës nga Prokurori i Shtetit në Gjykatën Themelore, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mban shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, merr vendim mbi kërkesat për hedhje të aktakuzës, merr vendim mbi kërkesat për të përjashtuar dëshmitë, dhe merr vendim mbi kërkesën për

caktim të paraburgimit apo masat tjera për të siguruar praninë e të pandehurit.
2. Shqyrtimi gjyqësor mbahet nga gjyqtari i vetëm gjykues apo nga trupi gjykues, siç përcaktohet me këtë Kod.

KAPITULLI IX FILLIMI I HETIMEVE DHE PROCEDURA PENALE

1. FAZAT E PROCEDURËS PENALE

Neni 68
Fazat e procedurës penale

Sipas këtij Kodi të Procedurës Penale, procedura penale ka katër faza të ndryshme: fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik. Procedurës penale mund t'i paraprijnë veprimet fillestare të policisë ose mbledhja e informatave sipas nenit 84 të këtij Kodi.

Neni 240
Gjykimi penal që zbatohet vetëm pas ngritjes së aktakuzës

1. Pas përfundimit të hetimit ose kur Prokurori i Shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale apo vepra penale, procedura para gjyqit mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit.

[...]

Neni 241
Aktakuza

1. Aktakuza përmban:

1.1. përcaktimin e gjykatës ku do të mbahet shqyrtimi gjyqësor;
1.2. emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat e tij personale;
1.3. të dhënat nëse është shqiptuar paraburgimi dhe sa kohë ka zgjatur ose masat e urdhëruara kundër të pandehurit për sigurimin e pranisë së tij, nëse ai ndodhet në liri dhe nëse ai është liruar para ngritjes së aktakuzës, sa është mbajtur në paraburgim.

1.4. kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale;
1.5. emërtimin ligjor të veprës penale duke iu referuar dispozitave të Kodit Penal;
1.6. Rekomandimin për provat që duhet prezantuar në shqyrtimin gjyqësor së bashku me emrat e dëshmitarëve dhe ekspertëve, shkresat që duhet lexuar dhe sendet që duhet marrë si provë.
1.7. Shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore;
1.8. Nëse është zbatuar mundësia hetuese e veçantë, në aktakuzë duhet të ceken emrat e gjyqtarëve të kolegjit që ka drejtuar mundësinë hetuese të veçantë.
1.9. Aktakuza përcakton me saktësi çdo ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, fonde apo pasuri tjera që mund t'i nënshtrohen konfiskimit. Aktakuza po ashtu përshkruan provat e nevojshme që kërkohen për të arsyetuar konfiskimin nga Kapitulli XVIII i këtij Kodi.

2. Nëse i pandehuri gjendet në liri, prokurori i shtetit në aktakuzë mund të propozojë që të jepet urdhri për paraburgim, e kur i pandehuri gjendet në paraburgim, prokurori i shtetit mund të propozojë që ai të lirohet.

3. Një aktakuzë mund të ngritët për disa vepra të ndryshme penale ose ndaj disa të pandehurve vetëm kur në pajtim me nenin 35 të këtij Kodi mund të zbatohet procedura e përbashkët.

Neni 242
Procedura për ngritjen e aktakuzës

1. Aktakuza i paraqitet gjykatës kompetente në aq kopje sa ka të pandehur dhe mbrojtës të tyre dhe një kopje shtesë për gjykatën. Gjithashtu, gjykatës i dërgohet edhe lënda komplete e hetimit nga prokurori i shtetit.
2. Gjykata cakton gjyqtarin ose trupin gjykues me kryetarin e tij nëpërmjet një procesi transparent e të drejtë për caktimin e çështjeve, ashtu siç duhet. Nëse është zbatuar mundësia hetuese e veçantë, njëri nga gjyqtarët e kolegjit caktohet si gjyqtar i vetëm gjykues ose si kryetar i trupit gjykues ose si anëtar i trupit gjykues.

3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton sipas detyrës zyrtare nëse ka kompetencë mbi çështjen që përbën aktakuzën.
4. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës.
5. Nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës.
6. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues njofton prokurorin e shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre për kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

Neni 243
Shkresat që plotësojnë aktakuzën

1. Në të njëjtën kohë me paraqitjen e aktakuzës, prokurori i shtetit paraqet edhe dokumentet e mëposhtme kur është e nevojshme:
1.1. prokurori i shtetit paraqet mbështetjen e pohimit nga neni 263 të këtij Kodi së bashku me deklaratat e marra nga neni 132 të këtij Kodi apo provat e siguruara nga neni 219, paragrafi 6. të këtij Kodi të cilat synon t'i paraqesë si prova të drejtpërdrejta pa praninë e dëshmitarëve. Mbështetja e pohimit përshkruan provat e pavarura që vërtetojnë deklaratat të cilat prokurori i shtetit synon t'i paraqesë si prova të drejtpërdrejta. Kjo mbështetje e pohimit mund të plotësohet ose të paraqitet në një kohë më të vonshme nëse dëshmitari për të cilin zbatohet kjo dispozitë nuk është më në dispozicion për të dëshmuar në shqyrtim gjyqësor.
1.2. prokurori i shtetit paraqet kërkesë për të vazhduar apo për të zbatuar ndonjë nga masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit. Nenet 173 deri 193 të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht për çfarëdo kërkese nga ky paragraf.

2.Prokurori i shtetit mund të paraqesë mbështetje të pohimit apo kërkesa nga ky nen edhe më pas nëse nuk ka mundur ta dijë bazën për paraqitjen e njoftimit apo kërkesës në kohën kur është ngritur aktakuza.

Neni 244
Materialet të cilat i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës

1. Jo më vonë se nga ngritja e aktakuzës, prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit apo mbrojtësit kryesor materialet e

mëposhtme ose kopjen e tyre të cilat janë në posedim, në kontroll ose në mbrojtje të tij, nëse këto materiale nuk i janë dhënë mbrojtësit gjatë hetimit:
1.1. procesverbalet mbi deklarimet ose pohimet, të nënshkruara apo të panënshkruara nga i pandehuri;
1.2. emrat e dëshmitarëve të cilët prokurori i shtetit ka ndërmend t'i thërret për dëshmim dhe çdo deklarim të mëhershëm të dhënë nga dëshmitarët e tillë;
1.3. të dhënat mbi identifikimin e personave për të cilët prokurori i shtetit e di se posedojnë prova të pranueshme dhe shfajësuese ose informata lidhur me çështjen dhe çdo procesverbal të deklarimeve, të nënshkruar apo të panënshkruar nga personat e tillë për këtë çështje;
1.4. rezultatet e ekzaminimit fizik dhe mendorë, testet shkencore ose eksperimentet e bëra lidhur me çështjen;
1.5. kallëzimet penale dhe raportet e policisë; dhe
1.6. përmbledhjet ose referencat për provat materiale të mbledhura gjatë hetimit.

2. Deklarimet e dëshmitarëve i vihen në disponim të pandehurit në gjuhën që ai e kupton dhe e flet.

3. Pas ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit çfarëdo materiali të ri të paraparë në paragrafin 1. të këtij neni brenda dhjetë (10) ditëve nga pranimi i tyre.

4. Për dispozitat e këtij neni vlejnë masat për mbrojtjen e të dëmtuarit, dëshmitarëve, të privatësisë së tyre dhe të dhënave konfidenciale, siç parashihet me ligj.

Neni 250
Kërkesa për hedhjen e aktakuzës

1. Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kërkesë për hedhjen e aktakuzës, bazuar në këto arsye:
1.1. vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;
1.2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
1.3. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra penale është e përfshirë në falje ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose

1.4. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.

2.Prokurorit të shtetit duhet t'i jepet mundësia që të përgjigjet ndaj kërkesës gojarisht apo me shkrim.

3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim me shkrim të arsyetuar me të cilin refuzon kërkesën ose hedh aktakuzën.

4. Secila palë mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit nga paragrafi 3. të këtij neni Ankesa duhet të bëhet brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i aktvendimit me shkrim.

12. Ndryshimi dhe zgjerimi i aktakuzës

Neni 350
Ndryshimi i aktakuzës në shqyrtim gjyqësor

1. Kur prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se provat e shqyrtuara tregojnë se gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar, ai në shqyrtim gjyqësor mund ta ndryshojë aktakuzën gojarisht dhe mund të propozojë që shqyrtimi gjyqësor të ndërpritet për përgatitjen e aktakuzës së re.

2. Nëse trupi gjykues lejon ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e aktakuzës së re, atëherë cakton afatin kur prokurori i shtetit detyrohet të paraqesë aktakuzën e re. Të akuzuarit i dërgohet kopja e aktakuzës së re. Nëse prokurori i shtetit në afatin e caktuar nuk paraqet aktakuzë të re, gjykata vazhdon shqyrtimin gjyqësor në bazë të aktakuzës së mëparshme.

3. Kur ndryshohet aktakuza, i akuzuari ose mbrojtësi mund të propozojnë ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes. Trupi gjykues mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes kur thelbi i aktakuzës është ndryshuar ose është zgjeruar.

Ligji Nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit

Neni 13
Autoriteti i Kryeprokurorit

1. *Secili Kryeprokuror është përgjegjës ndaj Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial për ushtrimin efektiv, efikas dhe korrekt të funksioneve prokuroriale të prokurorisë dhe të prokurorëve në kuadër të saj.*

2. *Secili Kryeprokuror është kreu administrativ i prokurorisë në të cilën është emëruar. Kryeprokurori mund të delegojë disa kompetenca, varësisht prej pajtimit të Kryeprokurorit të Shtetit.*

3. *Secili Kryeprokuror mund të ndërmarrë funksionet e ndjekjes penale të cilat i janë caktuar një prokurori vartës të shtetit në atë prokurori dhe nga ai apo ajo mund të marrë përsipër zhvillimin e drejtpërdrejtë të hetimeve apo të procedurës penale, me pëlqimin paraprak të Kryeprokurorit të Shtetit.*

4. *Secili Kryeprokuror do të caktojë lëndët prokurorëve brenda prokurorisë, duke marrë parasysh natyrën e lëndës, përvojën dhe specializimin e prokurorit.*

Ligji Nr. 05/L -034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit

Neni 4

Neni 13 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 13
Kryeprokurori

[...]

7. Kryeprokurorit të një prokurorie apo cilitdo prokuror tjetër të ndonjë prokurorie, Kryeprokurori i Shtetit apo prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, i autorizuar nga ai, mund t'u jap udhëzime të detyrueshme me shkrim për punën konkrete.

7.1. Udhëzime të tilla mund t'u japin prokurorëve në prokuroritë që drejtojnë edhe kryeprokurorët e prokurorive. Udhëzimet e tilla duhet të jenë të arsyetuara dhe nuk duhet të cenojnë pavarësinë funksionale dhe profesionale të prokurorëve, dhe në veçanti, nuk duhet të përmbajnë udhëzime për sa i përket kualifikimit të veprës, metodave të hetimit dhe mbledhjes së provave, si dhe arsyetimit të hetimit dhe aktakuzës.

7.2. Procedurat e brendshme i adresojnë rastet për të cilat do të nxirren udhëzime administrative dhe procedurat e brendshme hartohen për të adresuar situatat kur udhëzimi është ose joligjor ose në kundërshtim me ndërgjegjen e vartësit.

8. Udhëzimet jepen me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit.

9. Kryeprokurori i Shtetit apo Prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të autorizuar nga ai, mund të kërkojë raporte apo informata tjera me shkrim lidhur me progresin, gjendjen apo zgjidhjen e lëndëve të caktuara. Kërkesa e tillë duhet të bëhet me shkrim.

10. Secili nga kryeprokurorët e prokurorisë përkatëse mund të kërkojë raporte me shkrim apo informata të tilla nga një prokuror vartës.

11. Kryeprokurori i Shtetit dhe kryeprokurorët mund të delegojnë disa kompetenca tek vartësit e tyre.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

85. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

86. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
(...)
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

87. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

88. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, pasi që janë palë të autorizuara, kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 344/2019] e 2 qershorit 2020, të Gjykatës Supreme, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesit e kërkesave gjithashtu kanë sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

89. Megjithatë, në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2), në veçanti përcakton që:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

90. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Aktgjykimi [Pml. nr .344/2019] i 2 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjet Juridik] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; si dhe në shkelje të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe nenit 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës.

91. Gjykata vëren se pretendimet përkitazi me çështjen e ricilësimit të veprës penale përmes Aktakuzës së 3 majit 2017 bazuar në Udhëzimin e detyrueshëm, të 19 prillit 2017, parashtruesit e kërkesës i mbështesin duke pretenduar shkelje të nenit 31, nenit 102 dhe nenit 109 të Kushtetutës.

92. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 102 dhe 109 të Kushtetutës, Gjykata vë në dukje qëndrimin e saj të përgjithshëm se nenet e Kushtetutës të cilat nuk përcaktojnë, drejtpërdrejtë, të drejtat dhe liritë themelore nuk kanë efekt të pavarur. Efekti i tyre vlen vetëm për "gëzimin e të drejtave dhe lirive" që garantohen me dispozitat e Kapitullit II [Të drejtat dhe Liritë Themelore] dhe III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës (shih, në këtë aspekt, rastet e Gjykatës KI16/19, me parashtrues *Bejta Commerce*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 nëntorit 2019, paragrafi 42; dhe KI67/16, me parashtruese *Lumturije Voca*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 23 janarit 2017, paragrafi 128).

93. Prandaj, bazuar në arsyetimin e pretendimeve të ngritura nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata vë në pah se, në thelb, pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me nenet 102 dhe 109 të Kushtetutës, ndërlidhen me shkeljen e pretenduar të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës.

94. Si rrjedhojë, Gjykata konsideron se dy parashtruesit e kërkesave në mënyrë specifike pretendojnë që: (i) Aktakuza e ndryshuar, e 3 majit 2017 me ricilësimin e veprës penale nga vepra penale "vrasje" në bashkëkryerje në veprën penale "vrasje e rëndë" në bashkëkryerje, e bazuar në Udhëzimin e detyrueshëm, të 19 prillit 2017 të Zyrës së

Kryeprokurorit të Shtetit është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe se ata nuk kishin qasje në përmbajtjen e këtij Udhëzimi; ndërsa parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 po ashtu pretendon që: (ii) gjykatat e rregullta kanë treguar anshmëri gjatë shqyrtimit dhe vendosjes së rastit në procedurë penale; dhe se (iii) gjykatat e rregullta, përfshirë edhe Gjykatën Supreme nuk kanë adresuar vërejtjet e dhëna nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj të parë PAKR. nr. 256/2018, të 26 qershorit 2018.

95. Lidhur me këtë, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vendosur nëse një parashtrues ka qenë fajtor për kryerjen e veprës penale apo jo. Ajo nuk ka as juridiksion për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë apo për të vlerësuar nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë pasur dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI68/17, parashtrues: *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, paragrafi 50).

96. Në fund, Gjykata vë në pah se në trajtimin e pretendimeve të lartcekura të parashtruesve të kërkesës që ndërlidhen me të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë; KEDNJ), do të aplikojë praktikën e saj dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës ajo, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Përkitazi me pretendimin për ricilësimin e veprës penale përmes Aktakuzës, së 3 majit 2017

97. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës fillimisht specifikojnë se Aktakuza e 3 majit 2017 të Prokurorisë Themelore, e cila bazohej edhe në Udhëzimin e Detyrueshëm të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të 19 prillit 2017 iu ishte dorëzuar gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, të mbajtur më 4 maj 2017. Në vijim të kësaj, parashtruesit e kërkesës theksojnë se nga Prokuroria Themelore nuk iu ishte dhënë kopje apo qasje në leximin e përmbajtjes së Udhëzimit të detyrueshëm.

98. Së dyti, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktakuza e 3 majit 2017, e bazuar në Udhëzimin e detyrueshëm, të 19 prillit 2017 është në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e

Ligjit për Prokurorin e Shtetit, përmes të cilit ishte plotësuar dhe ndryshuar neni 13, dhe në këtë aspekt citojnë përmbajtjen e paragrafit 7 dhe pikës 7.1, të cilat dispozita i referohen nxjerrjes së një udhëzimi të detyrueshëm nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se në bazë të kësaj dispozite udhëzimi i detyrueshëm nuk duhet të përmbajë udhëzim për kualifikimin e veprës penale.

99. Gjykata fillimisht rikujton se Aktakuza e Prokurorisë Themelore, e 3 majit 2017, e cila përmbante ricilësimin e veprës penale të vrasjes së rëndë ishte ndryshuar para shqyrtimit fillestar në Gjykatën Themelore, të mbajtur më 4 maj 2017. Në kontekst të kësaj, Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesit e kërkesës në procedurën e shqyrtimit fillestar nuk e kishin kundërshtuar Aktakuzën e lartcekur të 3 majit 2017. Për më tepër, Gjykata rikujton se gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 kishte deklaruar pranimin e fajësisë për veprën penale "vrasje e rëndë' në bashkëkryerje për të cilën vepër ishte akuzuar edhe me Aktakuzën e ngritur të Prokurorisë, të 3 majit 2017.

100. Prandaj, bazuar nga të lartcekurat, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendimin e tyre përkitazi me ricilësimin e veprës penale përmes Aktakuzës, së 3 majit 2017 e kishin ngritur fillimisht (i) në procedurën e hedhjes së aktakuzës të zhvilluar para Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, e cila procedurë kishte përfunduar me nxjerrjen e Aktvendimit Pn. nr. 520/2017, të 6 korrikut 2017, të Gjykatës së Apelit dhe më pas këtë pretendim të tyre e kishin ngritur edhe (ii) në procedurën e shqyrtimit gjyqësor e cila kishte përfunduar me nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar, Pml. nr. 344/2019, të 2 qershorit 2020 të Gjykatës Supreme.

101. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për ricilësim të veprës penale përmes Aktakuzës së 3 majit 2017 janë shqyrtuar dhe vlerësuar në procedurën përkatëse për hedhje të aktakuzës, pas të cilës procedurë dhe për pasojë konfirmimit të aktakuzës edhe nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit është zhvilluar edhe procedura e shqyrtimit gjyqësor. Në lidhje me këtë, Gjykata në parim vlerëson se pretendimet e parashtruesve të kërkesës që i referohen procedurës së ngritjes së aktakuzës nga Prokuroria Themelore, përfshirë edhe ricilësimin e veprës penale dhe konfirmimit të saj nga gjykatat janë shqyrtuar dhe në lidhje me to është vendosur me Aktvendimin PN. nr. 520/2017, të 6 korrikut 2017 e Gjykatës së Apelit, i cili në këtë procedurë konsiderohet si vendim final. Megjithatë, ashtu siç është elaboruar edhe më lart, Gjykata përsërit se këtë pretendim specifik parashtruesit e kërkesës në mënyrë të vazhdueshme e kishin ngritur edhe gjatë procedurës së

shqyrtimit gjyqësor dhe pas përfundimit të saj. Në procedurë të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kishin konstatuar se ky pretendim ishte shqyrtuar në procedurën e shqyrtimit të dytë, respektivisht procedurën e hedhjes së Aktakuzës përmes aktvendimeve PKR. nr. 36/2017, të 5 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore dhe Aktvendimit PN. nr. 520/2017, të 6 korrikut 2017 të Gjykatës së Apelit. Megjithatë, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj të kontestuar kishte adresuar dhe elaboruar të njëjtin pretendim të ngritur në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe për pasojë, kishte ofruar edhe konstatim përkitazi me bazueshmërinë e këtij pretendimi.

102. Prandaj, duke marrë për bazë faktin e shqyrtimit të këtij pretendimi nga gjykatat e rregullta në të dy procedurat, përkatësisht procedurës së hedhjes së aktakuzës dhe procedurës së shqyrtimit gjyqësor nga gjykatat e rregullta, Gjykata këtë pretendim të parashtruesve të kërkesës përkitazi me ricilësimin e veprës penale do ta trajtojë në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe në lidhje me këtë do t' i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës përkitazi me parimet e vendosura që i referohen procedurës penale në tërësinë e saj, përfshirë edhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me ricilësimin e veprës penale në procedurë të ngritjes së Aktakuzës.

103. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson se praktika e GJEDNJ-së përcakton se drejtësia e një procedure vlerësohet në tërësi (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës,* nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi (shih, rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin nr. KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

104. Në këtë drejtim, duhet pasur parasysh se "drejtësia" që kërkohet me nenin 31 nuk është drejtësi "substanciale", por drejtësi "procedurale". Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në kushte të njëjta në gjykatë (shih, *mutatis mutandis,* rasti i Gjykatës KI42/16 parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).

105. Përderisa, përkitazi me çështjet që ndërlidhen me çështjen e ricilësimit të veprës penale përmes aktakuzës dhe njoftimit të saj te palët, Gjykata po ashtu i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila, në parim

ka theksuar se neni 6, paragrafi 3 (a) i KEDNJ-së nuk përcakton ndonjë kërkesë specifike formale për mënyrën se si i akuzuari duhet të informohet për natyrën dhe shkakun e aktakuzës të ngritur kundër tij (shih rastet e GJEDNJ-së, *Pélissier dhe Sassi kundër Francës* [DHM], Aktgjykim i 25 marsit 1999, paragrafi 53; *Drassich kundër Italisë*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2007, paragrafi 34; *Giosakis kundër Greqisë* (nr. 3), Aktgjykim i 3 majit 2011, paragrafi 29). Në lidhje me këtë, GJEDNJ nënvizoi se *"Aktakuza luan një rol vendimtar në procesin penal, në atë që është nga momenti i dorëzimit të saj me shkrim te i pandehuri, përmes së cilës zyrtarisht njoftohet me shkrim përkitazi me bazën faktike dhe ligjore të akuzave kundër tij"* (shih rastin *Kamasinski kundër Austrisë*, Aktgjykim i 19 dhjetorit 1989, paragrafi 79).

106. GJEDNJ më tej kishte specifikuar që i akuzuari duhet të jetë i njoftuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë për çdo ndryshim në aktakuzë, duke përfshirë ndryshimet përkitazi me "shkakun" e saj dhe duhet të sigurohet që i njëjti po ashtu të ketë kohë të mjaftueshme dhe mundësi të përshtatshme për të reaguar ndaj aktakuzës në mënyrë që të organizoj mbrojtjen e tij në bazë të çdo informacioni apo akuze të re (shih rastet e GJEDNJ-së-së, *Mattoccia kundër Italisë*, Aktgjykim i 25 korrikut 2007, paragrafi 61; dhe *Varela Geis kundër Spanjës*, Aktgjykim i 5 marsit 2013, paragrafi 54).

107. GEDNJ po ashtu ka specifikuar se informatat përkitazi me Aktakuzën, përfshirë karakterizimin ligjor që gjykata mund të miratojë në këtë çështje, duhet që t'i dorëzohet gjykatës ose në formë të aktakuzës ose të paktën gjatë procedurës së gjykimit me mjete të tjera siç është zgjerimi formal ose i nënkuptueshëm i aktakuzës (shih rastin e GJEDNJ-së *I.H. dhe të tjerët kundër Austrisë*, Aktgjykim i 20 prillit, paragrafi 34).

108. Një ricilësim i aktakuzës konsiderohet të jetë mjaftueshëm i parashikueshëm për të akuzuarin nëse ka të bëjë me një element që është qenësor në lidhje me aktakuzën (shih rastet e GJEDNJ-së: De *Salvador Torres kundër Spanjës*, Aktgjykim i 24 tetorit 1996, paragrafi 33; *Sadak dhe Të tjerët kundër Turqisë* (nr. 1), Aktgjykim i 17 korrikut 2001, paragrafët 52 dhe 56; dhe *Juha Nuutinen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 24 prillit 2007, paragrafi 32). Po ashtu edhe çështja e ricilësimit të Aktakuzës nëse është shqyrtuar gjatë zhvillimit të procedurës penale përbën një element të mëtejshëm të rëndësishëm (shih rastin e GJEDNJ-së, *Penev kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 7 janarit 2010, paragrafi 41).

109. GJEDNJ më tej ka theksuar se mangësitë në njoftimin përkitazi me aktakuzën mund të përmirësohen në procedurën e apelit nëse i

akuzuari ka mundësi që pretendimin e tij përkitazi me ricilësimin e aktakuzës ta ngritë para gjykatave më të larta (shih rastet e GJEDNJ-së *Dallos kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 1 marsit 2001, paragrafët49-52; dhe *I.H. dhe Të tjerët kundër Austrisë*, i cituar më lart, paragrafët 36-38).

110. Në vijim të elaborimit të lartcekur, Gjykata duke iu referuar dispozitave ligjore, përkatësisht dispozitave të procedurës penale vëren se në bazë të nenit 240 të KPPRK-së procedura e ngritjes së aktakuzës fillon pas përfundimit të hetimeve. Rrjedhimisht, neni 241 i KPPRK-së përcakton se cilat janë elementet që duhet t'i përmbajë aktakuza dhe në vijim, neni 242 i KPPRK-së përcakton që aktakuza e ngritur nga Prokuroria i dorëzohet gjykatës kompetente e cila cakton mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e ngritjes së aktakuzës nga ana e Prokurorisë. Në vijim, në bazë të nenit 250 të KPPRK-së përcaktohet që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të pandehurit kanë të drejtë të iniciojnë procedurën e hedhjes së aktakuzës.

111. Në bazë të dispozitave të KPPRK-së pas përfundimit të procedurës për hedhje të aktakuzës, dhe në rastin kur kundërshtimet dhe ankesat e të pandehurve përkitazi me hedhje të aktakuzës janë refuzuar, fillon procedura e shqyrtimit gjyqësor, dhe në kuadër të kësaj të fundit dhe bazuar në kriteret e përcaktuara në nenet 350 dhe 351 të KPPRK-së po ashtu lejohet ndryshimi apo zgjerimi i aktakuzës nga ana e Prokurorisë.

112. Gjykata në aplikimin e parimeve të lartcekura të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në kuadër të procedurës pas ngritjes së Aktakuzës fillestare të 27 marsit 2017, fillimisht rikujton se bazuar në shkresat e lëndës, pas ricilësimit të veprës penale përmes Aktakuzës së 3 majit 2017, palët kishin pranuar një kopje të saj gjatë shqyrtimit fillestar të 4 majit 2017 në Gjykatën Themelore. Nga shkresat e rastit rezulton që parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 kishte pranuar edhe fajësinë në lidhje me kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, ashtu siç ishte specifikuar në Aktakuzën e ndryshuar të 3 majit 2017. Në kuadër të procedurës së shqyrtimit fillestar, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kishin kundërshtuar ricilësimin e veprës penale përmes Aktakuzës së lartcekur, të 3 majit 2017.

113. Pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar, në të njëjtën ditë, gjyqtari i procedurës parapake përmes aktvendimit kishte refuzuar pranimin e fajësisë për kryerjen e veprës penale të "vrasjes së rëndë" nga parashtruesi i kërkesës dhe kishte aprovuar pranimin e fajësisë nga të dy parashtruesit e kërkesës përkitazi me veprën penale "mbajtje në

pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 374, paragrafi 1 KPRK-së.

114. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesit e kërkesës kishin iniciuar procedurën e hedhjes së Aktakuzës PP. I. nr. 38/2016, të 3 majit 2017 përmes kundërshtimeve të tyre të paraqitura më 25 maj 2017 dhe 27 maj 2017, respektivisht në Gjykatën Themelore. Në kërkesat e tyre për hedhje të aktakuzës, parashtruesit e kërkesës në mënyrë specifike kishin ngritur edhe çështjen e ricilësimit të veprës penale përmes Aktakuzës së Prokurorisë Themelore, të 3 majit 2017, në të cilin rast kishin theksuar se Udhëzimi i detyrueshëm i 10 prillit 2017, i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit, dhe në këtë kontekst të njëjtit kishin specifikuar se një udhëzim i tillë nuk duhet të përmbajë *"udhëzime për ricilësim të veprës penale"*.

115. Gjykata Themelore përmes Aktvendimit PKR. nr. 36/2017, të 5 qershorit 2017 kishte refuzuar kërkesat e tyre si të pabazuara, duke konstatuar se dispozitivi i Aktakuzës së 3 majit 2017 dhe përshkrimi i veprimeve të parashtruesve të kërkesës i përgjigjet *në "tërësi ekzistimit të elementeve të veprës penale të vrasjes së rëndë"* nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4 dhe 1.5 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, si dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së. Për më tepër, Gjykata Themelore, duke iu referuar të gjitha provave të bashkëngjitura nga Prokuroria Themelore në Aktakuzë, konkludoi se *"në tërësi është mbështetur dyshimi i bazuar mirë se [parashtruesit e kërkesës] kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen"*. Bazuar në këtë arsyetim të Gjykatës Themelore, Gjykata vëren se ndonëse parashtruesit e kërkesës kërkesën e tyre për hedhje të Aktakuzës së 3 majit 2017 e kanë bazuar në Udhëzimin e detyrueshëm që sipas tyre është kundërligjor, Gjykata Themelore arsyetimin e saj për refuzimin e kërkesës së tyre për hedhje të aktakuzës e bazon në përmbajtjen e aktakuzës, respektivisht përshkrimit të veprimeve dhe të gjitha provave që Prokuroria i ka bashkëngjitur kësaj aktakuze. Gjegjësisht, Gjykata vëren se Gjykata Themelore nuk e adreson çështjen e Udhëzimit të detyrueshëm të 19 prillit 2017, por qëndrimin e saj në lidhje me ekzistimin e dyshimit të bazuar për kryerjen e veprave penale nga parashtruesit e kërkesës e bazon në elementet e gjendjes faktike, të ofruara nga Prokuroria Themelore dhe të cilat mbështeteshin në provat dhe dëshmitë materiale të bashkëngjitura në aktakuzë.

116. Në vijim, si rezultat i ankesës së parashtruesve të kërkesës kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit të saj PN. nr. 520/2017, të 6 korrikut 2017 kishte

vërtetuar qëndrimin e Gjykatës Themelore dhe kishte konkluduar se *"tani për tani eksiztojnë elementet qenësore të veprave penale për të cilat janë akuzuar [parashtruesit e kërkesës], dhe se nga provat të cilat i ka propozuar prokurori për lexim gjatë shqyrtimit gjyqësor në të cilat prova edhe e ka mbështetur dyshimin e bazuar me rastin e ngritjes së aktakuzës dhe plotësimin e saj do të vlerësohen në shqyrtimin gjyqësor"*.

117. Prandaj, bazuar në arsyetimet e lartcekura të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, Gjykata ripërsëritë se këto të fundit arsyetimin e tyre përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për ricilësimin e veprës penale përmes Aktakuzës së 3 majit 2017, në mënyrë specifike dhe thelbësore e kishin bazuar në elementet e veprimeve të parashtruesve të kërkesës të cilat bazoheshin në provat e bashkëngjitura nga Prokuroria Themelore në aktakuzë.

118. Tutje, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pas përfundimit të procedurës për hedhje të aktakuzës, pretendimin e tyre përkitazi me ricilësimin e veprës penale përmes Aktakuzës së 3 majit 2017 bazuar në Udhëzimin e detyrueshëm të 19 prillit 2017 e kishin ngritur edhe në procedurën e shqyrtimit gjyqësor, respektivisht në procedurë të rigjykimit dhe rivendosjes në Gjykatën Themelore, në Gjykatën e Apelit dhe në fund edhe në Gjykatën Supreme. Thënë këtë, Gjykata po ashtu rikujton se Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj të parë PKR. nr. 36/2017, të 16 marsit 2018 parashtruesit e kërkesës i kishte shpallur fajtorë për kryerjen e veprës penale të "vrasjes" nga neni 178 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, duke konstatuar se në veprimet e tyre nuk ekzistonin elementet e kryerjes së veprës penale të vrasjes së rëndë. Megjithatë, Gjykata e Apelit në këtë pikë kishte anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe rastin e kishte kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

119. Në vijim të kësaj, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore në procedurë të rigjykimit dhe rivendosjes përmes Aktgjykimit PKR. nr. 41/18, të 18 qershorit 2019 kishte konstatuar se pretendimi përkitazi me ricilësimin e veprës penale përmes Aktakuzës së 3 majit 2017 është i pabazuar për arsye se në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar kundërshtime dhe ankesa respektivisht, të cilat ishin refuzuar si të pabazuara përmes Aktvendimit PKR. nr. 36/17, të 5 qershorit 2017, të Gjykatës Themelore dhe Aktvendimit PN. nr.. 520/2017, të 6 korrikut 2017 të Gjykatës së Apelit. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore duke u bazuar në faktin se në lidhje me pretendimin përkitazi me Aktakuzën e 3 majit 2017 ishte vendosur *"nga gjykata e instancës më të lartë, si dhe duke u bazuar edhe në dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale ku është e paraparë se prokuroria ka të drejtë të ndryshojë aktakuzën,*

por palëve duhet t' ju jepet e drejta që t' i paraqesin kundërshtimet e tyre, bazuar në faktin se aktakuza është ndryshuar para seancës së shqyrtimit fillestar, e të gjitha palët i kanë paraqitur kundërshtimet e tyre, e për të cilat kundërshtime është vendosur, sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim është i pabazuar dhe aktakuza është e ligjshme".

120. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 303/2019, të 20 shtatorit 2019 vërtetoi se pretendimi i parashtruesve të kërkesës përkitazi me ricilësimin e veprës penale është i pabazuar pasi që në lidhje me këtë është vendosur në procedurën e hedhjes së aktakuzës, në të cilën procedurë është konfirmuar aktakuza dhe për pasojë procedura penale është vazhduar në shqyrtim gjyqësor.

121. Përfundimisht, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit PML. nr. 344/2019 të 2 qershorit 2020 përkitazi me këtë pretendim të parashtruesve të kërkesës, kishte vlerësuar se *"[...] ndryshimi i aktakuzës me ricilësim të veprës penale nga vrasje në bashkëkryerje në vrasje të rëndë në bashkëkryerje nuk është bërë në mënyrë të kundërligjshme ashtu siç pa bazë pretendohet në kërkesa. Me asnjë dispozitë ligjore nuk i ndalohet Prokurorit që ta ndryshojë akuzën para shqyrtimit fillestar. Kurse fakti se një gjë e tillë është bërë sipas urdhrit të Kryeprokurorit e jo vlerësimit të Prokurorit të çështjes bie në detyrat dhe kompetencat e Prokurorit të Shtetit, [parashtruesit e kërkesës] kanë pas mundësi ta kundërshtojnë akuzën e ndryshuar, dhe çuditërisht mbrojtësja pavarësisht faktit se e konsideron si të kundërligjshme, nga procesverbali i shqyrtimit fillestar del se i dënuari [parashtruesi i kërkesës në rastin KI167 /20] e ka pranuar fajësinë përkitazi me veprën penale të ricilësuar dhe mbrojtësja nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë".*

122. Bazuar në elaborimin si më sipër, Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesve të kërkesës përkitazi me ricilësimin e veprës penale përmes Aktakuzës së 3 majit 2017 është adresuar dhe shqyrtuar në dy procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta. Në kontekst të kësaj, Gjykata konsideron se procedura e hedhjes së aktakuzës dhe procedura e shqyrtimit gjyqësor janë zhvilluar në pajtim me parimet e lartcekura, të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, parime këto të mishëruara edhe në dispozitat e procedurës penale. Rrjedhimisht, shikuar të gjithë procedurën penale në tërësinë e saj, Gjykata konstaton se të njëjtat nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI68/16, parashtrues: *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, paragrafi 55, dhe KI70/11, parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Besart*

Hima, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 32).

123. Nga sa më sipër, Gjykata vë në pah se parashtruesve të kërkesës iu është mundësuar zhvillimi i dy procedurave penale, përkatësisht procedurës së hedhjes së aktakuzës dhe procedurës së shqyrtimit gjyqësor bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se atyre iu është dhënë mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë të rëndësishme për rastin e tyre; se atyre iu është dhënë mundësia që të kontestojnë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës nr. KI118/17, Parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

124. Gjykata, më tej, konsideron se pakënaqësia e parashtruesve të kërkesës me rezultatin e procedurave nga gjykatat e rregullta nuk mundet vetvetiu të paraqesë pretendim të argumentueshëm për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Vendimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

125. Në fund, Gjykata duke u bazuar në shkresat e lëndës rikujton se më 22 tetor 2020 dhe përkatësisht pas nxjerrjes së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20, përmes përfaqësueses së tij ligjore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit kishte ngritur shqetësimet lidhur me mosdorëzimin e Udhëzimit të detyrueshëm, të 19 prillit 2017 nga Prokuroria Themelore dhe Gjykata Themelore. Ndërsa, më 23 tetor 2020, po i njëjti parashtrues në Gjykatën Themelore kishte kërkuar që t' i dorëzohet kopja e Udhëzimit të lartcekur të Detyrueshëm të 19 prillit 2017. Prokurori i Shtetit përmes Njoftimit të tij, të 13 nëntorit 2020 ishte përgjigjur si në vijim: *"Udhëzimi i Detyrueshëm A. nr. 140/2017 i dt. 10 prill 2017 i lëshuar nga Unë, në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit i referohet ekskluzivisht vetëm se prokurorit të shtetit [A.U], i cili është i ngarkuar për trajtim procedural penal në çështjen penale PP./I. Nr. 38/2016. Pra, i njëjti udhëzim i detyrueshëm gjatë tërë kohës së trajtimit të këtij rasti penal nga prokurori i shtetit në fjalë, asnjë pale tjetër në këtë procedurë penale nuk i referohet dhe nuk mund te pajiset me të, ngase*

i njëjti paraqet akt intern në kuadër të sistemit prokurorial. Për më tej, në funksion të transparencës dhe mos cenimit të parimit të barazisë së palëve në procedurë penale, Ju mund të keni vetëm qasje për shikimin e përmbajtjes së udhëzimit të sipërcekur në prezencën time, në mënyrë që në të ardhmen me rastin e ushtrimit eventual nga ana e juaj të mjeteve juridike të rregullta ashtu edhe të jashtëzakonshme kundër aktgjykimit të gjykatës kompetente lidhur me këtë çështje penale, të mund ta atakoni atë aktgjykim sipas arsyeve-bazave të parashikuara ligjore në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës". Ndërsa, Gjykata Themelore përmes shkresës së 28 tetorit 2020 ishte përgjigjur se *"[...] trupat gjykues kanë vendosur në të gjitha instancat gjyqësore, lidhur me të gjitha shkresat të cilën e kërkoni ju për këtë lëndë e cila është e kryer dhe arkivuar në Gjykatë".*

126. Në kontekst të kësaj të fundit dhe marrë për bazë faktin që këto fakte i referohen rrethanave pas nxjerrjes së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, dhe i njëjti Aktgjykim i kontestuar si vendim i fundit dhe përfundimtar në procedurë penale përbën edhe objektin e çështjes së kërkesave të parashtruesve të kërkesës, Gjykata konsideron se të njëjtat nuk mund të adresohen dhe shqyrtohen në kuadër të procedurës penale të zhvilluar para gjykatave të rregullta, e cila procedurë në bazë të shkresave të lëndës është përfunduar me nxjerrjen e Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme.

127. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre përkitazi me ricilësimin e veprës penale përmes Aktakuzës së 3 majit 2017, dhe rrjedhimisht konstaton se ky pretendim është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me nenin 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.

II. *Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20 për mungesë të paanshmërisë në gjykatat e rregullta*

128. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 në kërkesën tij specifikon se *"Në këtë procedim penal siç e kemi sqaruar më sipër, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, në mënyrë te pakuptimtë, gjyqtarët, në të gjitha fazat, nuk kanë qenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksionit të tyre [ka qenë e dukshme siç është sqaruar më sipër, janë dhënë detyrat nga gjykata e shkallës së dytë, për gjykatën e shkallës së parë, kjo në rigjykim nuk i ka kryer detyrat e përcaktuara në vërejtjet e gjykatës së shkallës së dytë, ka vendosur me mënyrën e vet".* Në vijim, parashtruesi i kërkesës

specifikon se edhe Gjykata e Apelit *"në ushtrimin e funksionit të saj nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme dhe vendosja e saj, procedimi i tillë, përfaqëson shkelje të paragrafit 4 të nenit 102 të Kushtetutës. E gjithashtu është shkelur edhe paragrafi 5 me te gjitha garancitë e tij"*.

129. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata vë në pah se parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 pretendon mungesë të paanshmërisë nga ana e Gjykatës Themelore dhe ajo e Apelit. Në kontekst të pretendimit për mungesë të paanshmërisë dhe pavarësisë së gjyqësorit, parashtruesi i kërkesës në këtë rast pretendon edhe shkelje të nenit 32 dhe nenit 54 të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata rikujton se pretendimet për mungesë të paanshmërisë dhe pavarësisë së gjykatave hyn në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

130. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore kishin parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit dhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Megjithatë, bazuar në shkresat e lëndës, përfshirë edhe dosjen e plotë të rastit të dorëzuar nga Gjykata Themelore nuk rezulton që pretendimi i lartcekur i parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20 përkitazi me mungesën e paanshmërisë në Gjykatën Themelore të jetë ngritur në ankesën e tij të parashtruar në Gjykatën e Apelit dhe rrjedhimisht po ashtu nuk rezulton që pretendimi i të njëjtit parashtrues për mungesë të paanshmërisë në Gjykatën e Apelit të jetë ngritur edhe në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

131. Në një kontekst të tillë, kur pretendimet e parashtruesve të kërkesës as formalisht por as në përmbajtje nuk janë ngritur para gjykatave të rregullta, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial, dhe rikujton se në rrethana të tilla, pretendimet e tilla nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata për mungesë të shterimit të mjeteve juridike në kuptim substancial. Bazuar në po të njëjtën praktikë gjyqësore, Gjykata kishte refuzuar shqyrtimin e pretendimeve përkatëse sepse të njëjtat nuk ishin ngritur asnjëherë para gjykatave të rregullta (shih ndër të tjera, edhe në rastet e Gjykatës, KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2009, paragrafi 71; KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 92; KI155/18, parashtrues *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shtatorit 2019, paragrafi 50; dhe KI239/19, parashtrues *Hakif Veliu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2021, paragrafi 147).

132. Gjykata rithekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në "*substancë*" para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dy kuptimet (shih, po ashtu, rastet e Gjykatës, KI71/18, parashtrues, *Kamer Borovci*, *Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafin 73; rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 94).

133. Një qëndrim i tillë është në përputhshmëri të plotë edhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, pranë gjykatave të rregullta kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës, KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 93; dhe rastin KI239/19, cituar më lart, paragrafi 147).

134. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës rezulton se këto pretendime specifike të parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20 janë ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, që të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngrit drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafi 74; rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 95; rastin KI239/19, cituar më lart, paragrafi 150).

135. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se ky pretendim duhet të refuzohet si i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores se punës.

III. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20 se gjykatat e rregullta, përfshirë edhe Gjykatën Supreme nuk kanë adresuar vërejtjet e dhëna përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 256/2018, të 26 qershorit 2018, të Gjykatës së Apelit

136. Parashtruesi i kërkesës në rastin KI167/20 specifikon se Gjykata Themelore, në procedurë të rigjykimit dhe rivendosjes përmes Aktgjykimit PKR. nr. 41/18, të 26 qershorit 2019 nuk i ka marrë parasysh vërejtjet e dhëna të Gjykatës së Apelit, të dhëna përmes Aktgjykimit të saj të parë PAKR. nr. 256/2018, të 29 qershorit 2018.

137. Në vijim, sipas parashtruesit të kërkesës edhe vetë Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj të dytë PAKR. nr. 393/2019 nuk kishte marrë parasysh vërejtjet e dhëna përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 256/2018, të 29 qershorit 2018 të Gjykatës së Apelit. Parashtruesi i kërkesës vazhdon me pretendimin që po të njëjtat vërejtje nuk ishin marrë parasysh as nga Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj të kontestuar.

138. Në kontekst të këtij pretendimi, Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj PAKR. nr. 256/2018, të 29 qershorit 2018, ndër të tjera, kishte vendosur që të aprovojë ankesat e Prokurorisë Themelore, dhe [parashtruesve të kërkesës], por edhe "sipas detyrës zyrtare" kishte anuluar Aktgjykimin PKR. nr. 36/2017, të 16 marsit 2018, të Gjykatës Themelore përkitazi me veprën penale "vrasje" në bashkëkryerje nga neni 178 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim dhe rivendosje. Përmes këtij Aktgjykimi, Gjykata e Apelit kishte obliguar Gjykatën Themelore, që në rigjykim të veprojë në pajtim me vërejtjet e dhëna nga kjo gjykatë, përkatësisht: t' i eliminojë kundërthëniet në dispozitivin e Gjykatës Themelore; të procedojë edhe njëherë me të gjitha provat me qëllim të "zbardhjes së drejtë dhe të plotë të fakteve"; të marrë për bazë deklaratat e dëshmitarëve okularë në vendin e ngjarjes; të bëhet rikonstruimi i vendit të ngjarjes; pas procedimit të provave duhet që të njëjtat t' i vlerësojë në pajtim me nenin 361 të KPPRK-së; të nxirren konkluzione të drejta dhe të ligjshme që mbështeten në provat e proceduara; dhe rrjedhimisht të nxirret vendimi përkatës dhe i

ligjshëm, përmes të cilit merren parasysh edhe pretendimet e tjera të cekura në ankesë.

139. Si rezultat i kthimit të rastit në rigjykim, Gjykata Themelore pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit, rikonstruimit të vendngjarjes, dëgjimit të dëshmitarëve dhe ekspertëve, pretendimeve të Prokurorisë Themelore dhe mbrojtjes së parashtruesve të kërkesës kishte "*konstatuar se të akuzuarit [parashtruesit e kërkesave] në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179, par. 1, nënpar. 1.5 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPRK-së*".

140. Në vijim, Gjykata e Apelit në adresimin e këtij pretendimi kishte vërtetuar se:

> *"[...] Në shqyrtimin gjyqësor është proceduar sipas akuzës së ndryshuar (neni 179 të KPPRK-së) të dënuarit janë shpall fajtor për veprën penale të vrasjes (neni 178 të KPPRK-së), por këtë aktgjykim përveç; mbrojtësve të të dënuarve e ka kundërshtuar edhe prokurori sa i përket shkeljes së ligjit penal, ndërsa Gjykata e Apelit e ka kthyer çështjen në rigjykim për shkak të shkeljeve esenciale (paqartësisë së dispozitivit të aktgjykimit në raport me veprën penale për të cilën janë shpall fajtor të dënuarit - vrasjes së zakonshme) të cilat kanë qenë të ndërlidhura edhe me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për çka ajo gjykatë ka sugjeruar rikonstruimin e vendit të ngjarjes me qëllim të vërtetimit të rrethanave në të cilat është privuar nga jeta i ndjeri [N.K], sidomos vërtetimit të faktet dhe rrethanat përkitazi me reagimin e tani [N.K.] në momentin kur i akuzuari ka shtënë në [N.K.]".*

141. Në kontekst të këtij pretendimi të njëjtë të parashtruar në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme vërtetoi se:

> *"Në rigjykim sipas vërejtjeve të shkallës së dytë është bërë rikonstruimi i vendit të ngjarjes dhe pas procedimit të provave tjera gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se në veprimet e [parashtruesve të kërkesës] qëndrojnë elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par. 1 pika 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veçanërisht në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të qarta sa i përket reagimit të ndjerit në momentin kur është shtënë në të. [...] Nga fakti se gjykata e shkalles së parë në rigjykim pas ndërmarrjes së veprimeve sipas sugjerimeve të procedurës penale dhe procedimit të provave konkludon se në veprimet e [parashtruesve të kërkesës] përmbushen elementet e*

veprës penale të vrasjes së rëndë për të cilën edhe janë akuzuar, nuk mund të konkludohet se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas sugjerimeve të shkallës së dytë, ngase pavarësisht obligimit ligjor për të ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe shqyrtuar çështjet kontestuese ajo pa nxjerr përfundim nëse fakti konkret është provuar respektivisht nëse është provuar përgjegjësia penale dhe elementet e veprës penale qëndron pretendimi se përderisa gjykata e shkallës së parë të [parashtruesin ë kërkesës në rastin KI170/20] me aktgjykimin e kundërshtuar për veprën penale të vrasjes së rëndë e ka dënuar me 16 vite burgim ndërsa nga hyrja e arsyetimit të aktgjykimit të shkallës së dytë del se ai është dënuar me 18 vite burgim, mirëpo kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me një lëshim teknik, i cili aktgjykimin nuk e bën të pakuptueshëm, ngase nga shkresat e lëndës rezulton qartë se [parashtruesi i kërkesës në rastin KI170/20] është dënuar me 16 vite burgim, kurse ky aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit".

142. Prandaj, Gjykata vlerëson se arsyetimi i gjykatave të rregullta, dhe në veçanti ai i Gjykatës Themelore në procedurë të rigjykimit [PKR. nr. 41/18] të 18 qershorit 2019] si rezultat i Aktgjykimit PAKR. nr. 256/2018 të 29 qershorit 2018 të Gjykatës së Apelit dhe përmes të cilit ishin përcaktuar vërejtjet që Gjykata Themelore obligohet që t' i marr parasysh është shumë i qartë dhe i plotë, dhe po ashtu vlerëson se edhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës Supreme kanë adresuar këtë pretendim të parashtruesve të kërkesës në ankesat e tyre dhe kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë.

143. Më tej, sa i përket çështjes së marrjes parasysh të vërejtjeve të Gjykatës së Apelit përmes Aktgjykimit PAKR nr. 256/2018 të 29 qershorit 2018, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e GJEDNJ-së *Pronina kundër Rusisë,* kërkesa nr. 65167/01, Vendim për papranueshmëri, i 30 qershorit 2005, rastet e Gjykatës KI06/17, parashtrues *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 tetorit 2017, paragrafi 38; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 58).

144. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata rithekson se arsyetimi i gjykatave të rregullta të dhëna në aktgjykimet e tyre respektive, të kontestuara nga parashtruesit e kërkesës janë të qarta dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI68/16, parashtrues: *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, paragrafi 55, dhe KI70/11, parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 32).

145. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se ky pretendim i parashtruesve të kërkesës është i pabazuar në baza kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me nenin 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.

Përfundim

146. Prandaj dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesat e parashtruesve të kërkesës janë të papranueshme.

(i) Pretendimi përkitazi me ricilësimin e veprës penale është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes nenit 47 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës;
(ii) Pretendimi i parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20 përkitazi me mungesën e paanshmërisë së gjykatave është i papranueshëm si rezultat i mosshterimit të mjeteve juridike në pajtim me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit, dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës; dhe
(iii) Pretendimi i parashtruesit të kërkesës në rastin KI167/20 përkitazi me mosmarrjen parasysh të vërejtjeve të dhëna përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 256/2018, të 29 qershorit 2018 të Gjykatës së Apelit nga gjykatat e rregullta gjatë shqyrtimit gjyqësor është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes nenit 47 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (1) (b) dhe (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 21 korrik 2021 njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesat të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin
20. 4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Remzije Istrefi-Peci	Gresa Caka-Nimani

KI01/20, Parashtrues: Momir Marinković, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-I-17-0074-A123 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 8 tetorit 2019

KI01/20, Aktgjykim i 29 korrikut 2021, publikuar më 19 gusht 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për seancë dëgjimore, heqje dorë nga seanca dwgjimore*

Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me privatizimin e Ndërmarrjes Shoqërore NSH "SHARR" dhe të drejtat e punëtorëve përkatës për t' iu njohur statusi i punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga ky privatizim, siç është përcaktuar në nenin 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në dhe paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores 2003/13. Parashtruesi i kërkesës, është njëri ndër ish-punëtorët të ndërmarrjes së lartcekur, i cili nuk ishte përfshirë në Listën Përfundimtare të publikuar më 7, 8 dhe 9 qershor 2012. Ankesa e tij në Kolegj të Specializuar ishte refuzuar si e pabazuar. Para Kolegjit të Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte ngritur pretendime që ndërlidheshin edhe me vërtetimin e gabuar të fakteve e edhe të diskriminimit dhe të njëjtat ishin refuzuar si të pabazuara edhe në nivel të Kolegjit të Apelit. Një seancë dëgjimore, nuk ishte mbajtur as në Kolegjin e Specializuar dhe as në Kolegjin e Apelit. E para kishte theksuar se *"Aktgjykimi është nxjerrë, pa mbajtur shqyrtimin publik, për shkak se faktet dhe argumentet juridike, të cilat janë ofruar janë të mjaftueshme të qarta. Kolegji nuk pret informata tjera relevante për shqyrtim. [...]"*, ndërsa e dyta, kishte theksuar se "*Kolegji i Apelit vendos që të heqë dore nga pjesa gojore e procedurës".*

Parashtruesi i kërkesës i kontestoi konstatimet e Kolegjit të Apelit para Gjykatës, duke pretenduar (i) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) për shkak të mosmbajtjes së seancës dëgjimore dhe mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor; (ii) shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së për shkak të trajtimit të pabarabartë; dhe (iii) shkelje të nenit 49 të Kushtetutës.

Gjykata, në rrethanat e këtij rasti, ka vlerësuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me mungesën e seancës dëgjimore, e drejtë kjo e garantuar, sipas sqarimeve të këtij Aktgjykimi, përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Në vlerësimin e pretendimeve përkatëse, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe të vet

Gjykatës në 5 (pesë) aktgjykimet e saj në rastet e ish-ndërmarrjes "Agimi" përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore, duke i sqaruar rrethanat në të cilat një e tillë është e domosdoshme, bazuar ndër të tjera, në Aktgjykimin e Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*. Gjykata ka sqaruar, ndër të tjera, se (i) mungesa e kërkesës së një pale për seancë dëgjimore jo detyrimisht nënkupton heqjen dorë nga një e drejtë të tillë dhe se vlerësimi i ndikimit të mungesës së një kërkese të tillë varet nga specifikat e ligjit dhe rrethanat e veçanta të një rasti; dhe (ii) në parim, palët kanë të drejtë në një seancë dëgjimore në të paktën një nivel të juridiksionit, përpos nëse "*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*", e të cilat bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim ndërlidhen me raste në të cilat shqyrtohen "*çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike*".

Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se (i) fakti që parashtruesi i kërkesës nuk ka kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Specializuar dhe atij të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tij nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtojë me nismën e tij domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance dëgjimore; (ii) Kolegji i Apelit, nuk kishte trajtuar "*çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike*", çështje këto bazuar në të cilat do të mund të kishin ekzistuar "*rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*", por përkundrazi, kishte shqyrtuar edhe çështje fakti edhe ligji; dhe (iii) Kolegji i Apelit nuk kishte arsyetuar "*heqjen dorë nga seanca gojore*". Duke marrë parasysh këto rrethana dhe arsyetimet e tjera të dhëna në këtë Aktgjykim, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-17-0074-A123] i 8 tetorit 2019, i Kolegjit të Apelit, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore.

Përfundimisht, Gjykata gjithashtu theksoi se (i) bazuar në ligjin e aplikueshëm për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për vlerësimin e vendimeve të Kolegjit të Specializuar dhe rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës, ka mundësinë e korrigjimit të mungesës së seancës dëgjimore në nivelin e gjykatës më të ulët, përkatësisht, Kolegjit të Specializuar; (ii) nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me mungesën e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe pretendimet përkitazi me shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së, dhe nenin 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së dhe nenin 49 të Kushtetutës sepse të njëjtat duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit në përputhshmëri me konstatimet e këtij Aktgjykimi; dhe (iii) konstatimi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret

ndërlidhet vetëm me garancitë procedurale për një seancë dëgjimore dhe në asnjë mënyrë nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI01/20

Parashtrues

Momir Marinković

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-I-17-0074-A123 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 8 tetorit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Momir Marinković, nga Komuna e Shtërpcës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [AC-I-17-0074-A123] e 8 tetorit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së) në lidhje me Aktgjykimin [C-II-12-0023] e 31 janarit 2017 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.

3. Parashtruesi i kërkesës, Aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-SË e ka pranuar më 29 tetor 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar përmes të cilit, pretendohet se parashtruesit të kërkesës iu janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me (i) nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ); (ii) nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së; dhe (iii) nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

5. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 10 janar 2020, Gjykata pranoi kërkesën e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës përmes postës.

8. Më 14 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.

9. Më 7 shkurt 2020, Gjykata (i) njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë kopjen e ankesës të dorëzuar në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së; (ii) i dërgoi një kopje të kërkesës DHPGJS-së, duke kërkuar gjithashtu që të dorëzojë kopjen e aktgjykimeve të Kolegjit të Specializuar dhe atij të Apelit në gjuhën shqipe dhe atë serbe në Gjykatë; dhe (iii) i dorëzoi një kopje të kërkesës edhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

10. Më 11 shkurt 2020, DHPGJS dorëzoi kopjet e aktgjykimeve të kërkuara në Gjykatë.

11. Më 27 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentin e kërkuar nga Gjykata.

12. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

13. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

14. Më 8 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama–Hajrizi, përmes Vendimit Nr. KI01/20, caktoi Gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi si Gjyqtare raportuese në vend të gjyqtares Gresa Caka-Nimani.

15. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021, të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

16. Më 29 korrik 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

17. Të njëjtën ditë, Gjykata (i) me shumicë konstatoi se kërkesa është e pranueshme; dhe (ii) me shumicë konstatoi se Aktgjykimi [AC-I-17-0074-A123] i 8 tetorit 2019 të Kolegjit i Apelit të DHPGJS-së nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

18. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës është ish-punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore NSH "SHARR" Hani i Elezit (në tekstin e mëtejmë: NSH "SHARR"), e cila në momentin e komercializimit të saj nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: UNMIK), më 13 qershor 2000, përbëhej nga 4 (katër) ndërmarrje, përkatësisht: (i) ndërmarrja e re "Lepenci" në Kaçanik; (ii) ndërmarrja e re "Silkapor" në Doganaj; (iii) ndërmarrja e re "Sharr Salonit" në Han të Elezit; dhe (iv) ndërmarrja "Sharr Cem" në Han të Elezit, të cilat gjatë periudhës nga 8 marsi 2004 deri më 9 dhjetor 2010, i ishin nënshtruar procesit të privatizimit nga AKP.

19. Më 7, 8 dhe 9 qershor 2012, respektivisht, AKP publikoi Listën Përfundimtare të punëtorëve me të drejtë përfitimi në njëzet përqind (20 %) të të ardhurave nga privatizimi i Ndërmarrjes përkatëse Shoqërore (në tekstin e mëtejmë: Lista Përfundimtare). Si datë e fundit për dorëzimin e ankesave në DHPGJS kundër kësaj Listës Përfundimtare ishte caktuar 30 qershori 2012.

20. Më 29 qershor 2012, parashtruesi i kërkesës, si rezultat i mospërfshirjes së tij në Listën Përfundimtare kishte parashtruar ankesë në DHPGJS. Përmes ankesës së tij, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar përfshirjen e tij në Listën Përfundimtare, duke pohuar se marrëdhënien e tij të punës me Ndërmarrjen Shoqërore e kishte filluar punën më 10 shkurt 1992 deri më 31 maj 1997, të cilën marrëdhënie e kishte vazhduar edhe pas procesit të riorganizimit të kësaj Ndërmarrje në Ndërmarrjen e re Shoqërore "Sharr Silkapor" më 1 qershor 1997 deri në mars të vitit 1999.

21. Më 27 korrik 2012, AKP kishte paraqitur përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës, përmes të cilës kishte propozuar që ankesa e tij të refuzohej si e pabazuar. Në përgjigjen e saj, AKP kishte specifikuar se (i) në bazë të librezës përkatëse të punës, marrëdhënia e tij e punës me Ndërmarrjen Shoqërore ishte mbyllur më 31 maj 1997, dhe pas kësaj date, parashtruesi i kërkesës "*nuk ka paraqitur dëshmi relevante që të dëshmojë vazhdimësinë e marrëdhënies së punës*"; dhe (ii) parashtruesi i kërkesës "*nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimi ligjor që të vazhdojë punësimin pas qershorit të vitit 1999*".

22. Më 31 janar 2017, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, duke vendosur në lidhje me të gjitha ankesat e ish-punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore, përmes Aktgjykimit [C-II-12-0023], ankesën e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar. Përmes këtij Aktgjykimi, Kolegji Specializuar, duke u referuar në paragrafin 11 të

nenit 68 (Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime) të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Shtojca e Ligjit për DHPGJS-në), kishte specifikuar se *"Aktgjykimi është nxjerrë, pa mbajtur shqyrtimin publik, për shkak se faktet dhe argumentet juridike, të cilat janë ofruar janë të mjaftueshme dhe të qarta. Kolegji nuk pret informata tjera relevante për shqyrtim. [...]"*. Ndërsa, në pjesën përkitazi me ankesën e parashtruesit të kërkesës, kishte arsyetuar se (i) parashtruesi i kërkesës nuk plotësonte kriteret e përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 10 (Të drejtat e të punësuarve) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 mbi Transformimin e të Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45 për Ndryshimin e Rregullores së 2003/13 mbi Transformimin e të Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13 e ndryshuar me Rregulloren nr. 2004/45) për arsye se në kohën e privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore, nuk kishte qenë i regjistruar si punëtor i kësaj Ndërmarrje; (ii) në bazë të kopjes së librezës së punës, të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës, nuk dëshmohej nëse libreza e punës "*është e mbyllur apo e hapur pas vitit 1997*"; dhe (iii) parashtruesi i kërkesës nuk ka ngritur pretendime lidhur me diskriminimin.

23. Më 10 mars 2017, kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, duke pretenduar vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Përkitazi me të parën, parashtruesi i kërkesës theksoi se (i) konstatimi i Kolegjit të Specializuar se në rastin e tij mungojnë dëshmitë për marrëdhënien e tij të punës pas 1 qershorit 1997 është "*i gabuar dhe në kundërshtim me provat e paraqitura materiale*" sepse bazuar në dëshmitë e dorëzuara vërtetohet që ai e ka filluar marrëdhënien e punës më 10 shkurt 1992, ndërsa e njëjta është ndërprerë në mars të vitit 1999 si pasojë e "*rrethanave të luftës, [...] e pas luftës për shkak të rrethanave të sigurisë dhe diskriminimit, faktikisht kam qenë në pamundësi të kryej punët e mia dhe detyrat e punës [...]";* (ii) libreza e tij e punës e bashkangjitur si dëshmi vërteton faktin se *"nuk ka përfundim të stazhit të punës pas datës 01.06.1997*"; (iii) deklaratat e të gjithë të punësuarve në ndërmarrjen e përmendur, në cilësinë e dëshmitarëve, do të mund të konfirmonin saktësinë e pretendimeve të tij; dhe (iv) bazuar në dëshmitë që ka dorëzuar vërtetohet se ai i plotëson kriteret e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13 e ndryshuar me Rregulloren nr.2004/45. Ndërsa, përkitazi me ish-punëtorët tjerë, parashtruesi i

kërkesës theksoi se Kolegji i Specializuar në shkelje të "*parimit për gjykim të barabartë dhe të drejtë*" ka trajtuar në mënyrë të pabarabartë "*të punësuarit të komunitetit joshqiptarë", sepse "një grup i ankesave të të punësuarve serbë të miratohet në bazë të diskriminimit e pjesa tjetër të refuzohet për shkak të mungesës së supozuar të paraqitjes së diskriminimit".* Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës gjithashtu njoftoi Kolegjin e Apelit se ai dhe disa ish-punonjës të tjerë të Ndërmarrjes Shoqërore, pretendimin e tyre për diskriminim e kishin paraqitur edhe në Institucionin e Avokatit të Popullit, më 10 tetor 2001.

24. Më 8 tetor 2019, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit [AC-I-17-0074-A123], ankesën e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar, duke konfirmuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar. Përmes këtij Aktgjykimi, Kolegji i Apelit, duke u referuar në paragrafin 1 të nenit 64 [Procedurat e ankesës me gojë] të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, kishte specifikuar se "*Kolegji i Apelit vendos që të heqë dore nga pjesa gojore e procedurës",* ndërsa, në pjesën përkitazi me ankesën e parashtruesit të kërkesës, kishte arsyetuar se: (i) parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar dëshmi të mjaftueshme se në kohën e privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore ka qenë punëtor i saj; (ii) para Kolegjit të Specializuar nuk është ankuar se ka qenë viktimë e diskriminimit si arsye e mos vazhdimit të marrëdhënies së punës, ndërsa pretendimin se ai ishte viktimë e diskriminimit si rezultat i mosvazhdimit të marrëdhënies së punës e ka ngritur për herë të parë pranë Kolegjit të Apelit; dhe (iii) parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet e të qënurit në listën e pagave në momentin e privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore ashtu siç përcaktohet me paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut, në mënyrë që atij të njihet e drejta për përfshirjen e tij në Listën Përfundimtare me të drejtë përfitimi në një pjesë të 20% të të ardhurave nga shitja e Ndërmarrjes Shoqërore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me (i) nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; (ii) nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së; dhe (iii) nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

26. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson se Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale për një (i) seancë dëgjimore; dhe (ii) vendim të arsyetuar gjyqësor.

27. Për sa i përket çështjes së parë, përkatësisht mungesës së një seance dëgjimore, parashtruesi i kërkesës thekson se një e tillë nuk është mbajtur as para Kolegjit të Specializuar dhe as para Kolegjit të Apelit, duke i pamundësuar palëve që të paraqesin dëshmitë e tyre lidhur me marrëdhënien e tij të punës në Ndërmarrjen Shoqërore. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, thekson se (i) bazuar në paragrafin 1 të nenit 64 [Procedurat e ankesës me gojë] të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka qenë i detyruar që të mbaje seancë dëgjimore publike dhe se një detyrim të tillë e ka bazuar në këtë ligj, pa marrë parasysh nëse një kërkesë për seancë dëgjimore është paraqitur ose jo, sepse mosparaqitja e kërkesës për seancë dëgjimore nuk nënkupton domosdoshmërisht heqjen dorë nga e drejta për këtë kërkesë; (ii) Kolegji i Apelit mund të jetë liruar nga ky detyrim veten nëse "*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat e justifikojnë mungesën e një seance dëgjimore*"; dhe (iii) Kolegji i Apelit i ka pamundësuar palëve të paraqesin dëshmitë e tyre, sepse *"asnjë rregullore nuk përcaktohet që libreza e punës është ekskluzivisht prova e vetme e ekzistencës së marrëdhënies së punës",* ndërsa kjo ishte dëshmia vendimtare bazuar në të cilën pretendimet e parashtruesit të kërkesës u refuzuan si të pabazuara, duke mos iu dhënë mundësia që përmes seancës dëgjimore, të paraqesë dëshmitë tjera të tij, duke përfshirë dëshmitarët, siç është përcaktuar në nenin 36 (Rregullat e përgjithshme mbi provat) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) në rastet *Exel kundër Republikës Çeke* (Aktgjykim, i 5 korrikut 2005) dhe *Gőç kundër Turqisë* (Aktgjykim i 11 korrikut 2002).

28. Ndërsa, për sa i përket çështjes së dytë, përkatësisht mungesës së një vendimi të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës thekson se Aktgjykimi i kontestuar dështon t' i tregojë palës se i njëjti është dëgjuar dhe gjithashtu, në mungesë të arsyetimit adekuat, i pamundëson palës që kundër tij të ushtrojë mjetet juridike efektivisht, garanci këto, sipas parashtruesit të kërkesës, të mishëruara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me arsyetimin e vendimit gjyqësor. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht rasteve *H kundër Belgjikës* (Aktgjykim i 30

nëntorit 1987) dhe *Hirvisaari kundër Finlandës* (Aktgjykim, i 25 dhjetorit 2001).

29. Gjithashtu, në mbështetje të pretendimeve të tij për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe rasteve të GJEDNJ-së, në rastet në vijim: *Fredin kundër Suedisë* (nr. 2) (Aktgjykim i 23 shkurtit 1994); *Allan Jacobson kundër Suedisë (*nr. 2), (Aktgjykim i 19 shkurtit 1998); *Gőç kundër Turqisë* (Aktgjykim i 11 korrikut 2002); *Fischer kundër Austrisë* (Aktgjykim i 26 prillit 1995); *Salomonsson kundër Suedisë* (Aktgjykim i 12 nëntorit 2002); *Dombo Beheer B.V. kundër Hollandës* (Aktgjykim i 27 tetorit 1993); *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, (Aktgjykim i 21 shkurtit 1975); *Stanev kundër Bullgarisë* (Aktgjykim i 17 janarit 2012); *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Aktgjykim i 28 majit 1985) *Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Aktgjykim i 21 shtatorit 1990); *Marković dhe të tjerët kundër Italisë* (Aktgjykim i 14 dhjetorit 2006); *Airey kundër Irlandës* (Aktgjykim i 9 tetorit 1979); dhe *Pretto dhe të tjerët kundër Italisë* (Aktgjykim i 8 dhjetorit 1983).

30. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson se ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me palët tjera në procedurë para Kolegjit të Specializuar dhe atij të Apelit edhe përkitazi me vlerësimin e fakteve edhe me interpretimin e ligjit. Sipas parashtruesit të kërkesës (i) dështmitë e paraqitura para DHPGJS-së, nuk janë trajtuar në mënyrë të njëjtë me punëtorët tjerë të përkatësisë shqiptare, sepse në rast të këtyre të fundit, "*regjistri nga libra amë e punëtorëve me arsyetimin se librezat e tyre të punës ishin shkatërruar"* dhe*" Libreza e Shëndetit dhe Vendimi i NSH-së",* ishin pranuar si dështmi për të vërtetuar marrëdhënien e punës, përderisa e njëjta nuk kishte ndodhur në rastin e tij. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës i referohet arsyetimit të dhënë në Aktgjykimin [C-II.-12-0023] e 31 janarit 2017 të Kolegjit të Specializuar në lidhje me dy ish-punëtorë të Ndërmarrjes Shoqërore, respektivisht K. B., me numër të lëndës [C-0026] dhe S. B., me numër të lëndës [C-0029]; dhe (ii) DHPGJS-së, ka vendosur në mënyrë të ndryshme bazuar në dështmi dhe pretendime identike edhe përkitazi me gjendjen faktike por edhe përkitazi me diskriminin. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës i referohet arsyetimit të Aktgjykimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së në lidhje me ish-punëtorin e Ndërmarrjes Shoqërore, D. V. me numër të lëndës [C-0004]. Për më tepër, në mbështetje të pretendimeve të tij për shkeljen e neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës gjyqësore

të GJEDNJ-së, respektivisht rasteve *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës* (Aktgjykim i 22 dhjetorit 2009); *Timishev kundër Rusisë* (Aktgjykim i 13 dhjetorit 2005); dhe *Zornić kundër Bosnje dhe Hercegovinës* (Aktgjykim, i 15 korrikut 2014). Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

31. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës, në esencë, ngrit pretendime që ndërlidhen me nenin 49 të Kushtetutës. Lidhur me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, thekson se (i) marrëdhënia e punës me Ndërmarrjen Shoqërore ka qenë e themeluar në bazë të dispozitave të "Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76)" dhe bazuar në nenin 219 të këtij Ligji, në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës është e domosdoshme që të punësuarit t' i dorëzohet një vendim me shkrim, vendim ky i cili parashtruesit të kërkesës asnjëherë nuk i është dorëzuar; dhe (ii) se "*marrëdhënia e tij punës zyrtarisht ekzistonte në kohën e privatizimit, dhe se libreza e punës dhe libri amë i punëtorëve në emër të parashtruesit nuk ishte mbyllur dhe nuk i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës kurrë nuk duhet shpërfillur*". Në këtë kontekst, dhe përfundimisht, parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se në rastin e tij është shkelur edhe "Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës".

32. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme, duke arsyetuar si në vijim *"marrë parasysh kohëzgjatjen e kësaj procedure para AKP-së dhe DHPGJS-së, Gjykata Kushtetuese të veprojë me prioritet sipas kësaj kërkese, përkatësisht paraqes propozimin për caktimin e masës së përkohshme"*.

33. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata të (i) aprovojë kërkesën e tij si të pranueshme; (ii) të konstatojë shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së; nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe nenit 49 të Kushtetutës; dhe (iii) të ndryshojë Aktgjykimin e kontestuar [AC-I-17-0074-A123] të 8 tetorit 2019 të Kolegjit të Apelit, "*duke vërtetuar të drejtën e tij në përfitim të 20% të të ardhurave nga privatizimi*" ose të urdhërohet Kolegji i Apelit që "*të përsëris procedurën*" në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24
[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
E drejta për një proces të rregullt

1. *E drejta për një proces të rregullt 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati*

të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

Neni 14
Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.
[...]

Protokolli Nr. 12 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 1
Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1.Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës në të cilën shtatë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me Protokollin, sipas dispozitave të nenit 8.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Shtojca e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit – Rregullorja e Punës e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 36
Rregullat e përgjithshme mbi provat

[...]
3. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Neni 64
Procedurat e ankesës me gojë

1. *Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkese për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.*
[...]

Neni 65
Paraqitja e provave të reja

Në rrethana të jashtëzakonshme dhe për arsye që dëshmohen mirë, Kolegji i Apelit mund t'i lejoj një pale paraqitjen e provave të reja që nuk kanë qenë në dispozicion të palës gjatë procedurës së shkallës së parë për vlerësimin e provave. Kërkesa me shkrim për një leje të tillë duhet së pari t'i dorëzohet Kolegjit të Apelit dhe duhet t'i dorëzohet palëve tjera jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së seancës kur propozohet paraqitja e këtyre provave. Kolegji i Apelit mund të autorizojë paraqitjen e provave të reja nëse vlerëson se në këtë mënyrë drejtësia do të vihet në vend.

Neni 68
Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime

1. Përveç nëse nuk përcaktohet saktësisht me këtë nen, procedura për lëndët që bazohen në ankesat që bien nën paragrafin 1.6. të nenit 4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme do të ndjek rregullat e tjera procedurale të përshkruara në këtë Shtojcë e që Dhoma e

Posaçme i zbaton mutatis mutandis nëse i vlerëson si të domosdoshme dhe në interes të drejtësisë.
2. Pas pranimit të listës së të punësuarve me të drejta legjitime në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo në bazë të çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas datës së shpalljes, duke kërkuar përfshirjen në një listë të tillë dhe/apo duke sfiduar përfshirjen e një apo më shumë personave tjerë në një listë të tillë. Personi i cili parashtron një kërkesë apo kundërshtim të tillë, do të përfshijë aty në deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështesin kërkesën apo kundërshtimin e tillë; ai person ka barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në kërkesë dhe/apo në kundërshtim.
[...]
6. Agjencia shpallë listën e saj përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime në mbështetje të paragrafit 5. të këtij neni e në përputhje me nenin 10.6. të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, ose në pajtim me çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas ditës së shpalljes për të kundërshtuar në listë të tillë dhe/apo në lidhje me shpërndarjen e fondeve të mbledhura nga Agjencia për personat e identifikuar në atë listë. Ankuesi(t) që parashtrojnë një ankesë të tillë përfshijnë një deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështetin ankesën e tillë; personat që ankohen kanë barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në ankesë.
[...]
11. Kolegji gjegjës i Specializuar, me nismë të vet apo në bazë të një kërkese me shkrim nga ankuesi(t) apo Agjencia, mund të vendos për mbajtjen e një apo më shumë seancave gojore lidhur me çështjen. Nëse mbahet një seancë gojore, atëherë Kolegji Specializuar do të udhëzojë Regjistër mbajtësin që, së paku pesë (5) ditë më herët para seancës gojore, t'i dorëzojë palëve një njoftim me shkrim për kohën dhe ditën e seancës së tillë.
[...]
14. Kolegji i Apelit zgjidhë të gjitha apelet e tilla urgjentisht.

Ligji nr. 06/L-086 për Dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit [publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me 27 qershor 2019]

Neni 69
Procedurat e ankesës me gojë

1. *Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkese për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.*
[...]

Rregullore Nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në Pronësi Shoqërore

Neni 10
Të Drejtat E të punësuarve

[...]
10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilit pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qënë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.
[...]

Rregullore Nr. 2004/45 për ndryshimin e Rregullores Nr. 2003/ 13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore

Neni 1
Ndryshimet

Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje,
[...]
B. Nenet 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 ndryshohen si vijon:
[...]
10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në

kohën e privatizimit apo të fillimit të procedurës së likuidimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vite. Kjo kërkesë nuk i përjashton punëtorët nga paraqitja e ankesës në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6., të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar po të mos kishin qenë të diskriminuar.
[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

34. Gjykata së pari, shqyrton nëse parashtruesi e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

36. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë

cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

37. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I-17-0074-A123] e 8 tetorit 2019 të Kolegjit të Apelit në lidhje me Aktgjykimin [C-II-12-0023] e 31 janarit 2017 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

38. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

39. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me privatizimin e Ndërmarrjes Shoqërore NSH "SHARR" dhe të drejtat e punëtorëve përkatës për t' iu njohur statusi i punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga ky privatizim, siç është përcaktuar në nenin 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në dhe paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores 2003/13. Parashtruesi i kërkesës, është njëri ndër ish-punëtorët të ndërmarrjes së lartcekur, i cili nuk ishte përfshirë në Listën Përfundimtare të publikuar më 7, 8 dhe 9 qershor 2012. Ankesa e tij në Kolegj të Specializuar ishte refuzuar si e pabazuar. Para Kolegjit të Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte ngritur pretendime që ndërlidheshin edhe me vërtetimin e gabuar të fakteve e edhe të

diskriminimit dhe të njëjtat ishin refuzuar si të pabazuara edhe në nivel të Kolegjit të Apelit. Një seancë dëgjimore, nuk ishte mbajtur as në Kolegjin e Specializuar dhe as në Kolegjin e Apelit. E para kishte theksuar se *"Aktgjykimi është nxjerrë, pa mbajtur shqyrtimin publik, për shkak se faktet dhe argumentet juridike, të cilat janë ofruar janë të mjaftueshme të qarta. Kolegji nuk pret informata tjera relevante për shqyrtim. [...]"*, ndërsa e dyta, kishte theksuar se "*Kolegji i Apelit vendos që të heqë dore nga pjesa gojore e procedurës"*.

40. Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e Kolegjit të Apelit para Gjykatës, duke pretenduar (i) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mosmbajtjes së seancës dëgjimore dhe mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor; (ii) shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së për shkak të trajtimit të pabarabartë; dhe (iii) shkelje të nenit 49 të Kushtetutës. Këto kategori pretendimesh, Gjykata do t' i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

41. Gjykata, në këtë aspekt, fillimisht do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore para DHPGJS-së. Për këtë qëllim, në vijim, Gjykata fillimisht (i) do t' i shtjellojë parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore siç është e garantuar përmes neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së; dhe më pas, (ii) do t' i aplikoj të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

(vi)Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore

42. Gjykata fillimisht thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka vendosur parimet themelore përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore. Bazuar në këtë praktikë gjyqësore, Gjykata gjithashtu ka përcaktuar parimet dhe përjashtimet përkatëse, bazuar në të cilat vlerësohet domosdoshmëria e mbajtjes së një seance dëgjimore, varësisht nga rrethanat e rasteve përkatëse. Rishtazi, përmes një numri aktgjykimesh, Gjykata ka vënë theks në këto parime, duke konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore para DHPGJS-së, përkatësisht edhe para Kolegjit të Specializuar edhe Kolegjit të Apelit, me rastin e përcaktimit të të drejtave të punëtorëve të ish-ndërmarrjes

"Agimi", pas privatizimit të të njëjtës, të cilave raste Gjykata në vijim do t' ju referohet si rastet e Gjykatës të ish-ndërmarrjes "Agimi". (Shih 5 (pesë) aktgjykimet në rastet e ish-ndërmarrjes "Agimi": KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI 151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI 159/19, me parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të jerët*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019, Aktgjykim, i 10 dhjetorit 2020; KI160/19, KI161/19,KI162/19, KI164/19, KI165/19, KI166/19,KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19,KI171/19, KI172/19, KI173/19 dhe KI178/19, me parashtrues *Muhamet Këndusi dhe të tjerët*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019, Aktgjykim i 27 janarit 2021; KI181/19, KI182/19 dhe KI183/19, me parashtrues *Fllanza Naka, Fatmire Lima dhe Leman Masar Zhubi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019; Aktgjykim i 27 janarit 2021; KI220/19, KI221/19, KI223/19 dhe KI234/19, me parashtrues *Sadete Koca Lila dhe të tjerët*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019, Aktgjykim, i 25 marsit 2021; dhe KI 186/19; KI187/19, KI200/19 dhe KI208/19, me parashtrues *Belkize Vula Shala dhe të tjerët;* Aktgjykim, i 28 prillit 2021). Gjykata, gjatë elaborimit të parimeve të shtjelluara të konfirmuara përmes Aktgjykimeve të lartcekura të Gjykatës dhe aplikimit të këtyre në rrethanat e rastit konkret do ti referohet Aktgjykimit të saj të parë në lidhje me ish-ndërmarrjen Agimi, gjegjësisht rasteve KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët).*

43. Parimet e shtjelluara në praktikën përkatëse gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe në rastet e lartcekura, përkatësisht aktgjykimet e Gjykatës në rastet e ish-ndërmarrjes "Agimi", theksojnë se karakteri publik i procedurave para organeve gjyqësore të referuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, mbron palët ndërgjyqëse nga administrimi i drejtësisë në fshehtësi, në mungesë të një shqyrtimi publik. Publiciteti i procedurave gjyqësore është gjithashtu një nga mekanizmat kryesorë përmes të cilës ruhet besimi në drejtësi. Një parim i tillë, për më tepër, kontribuon në arritjen

e qëllimeve të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike të mishëruara në Kushtetutë dhe KEDNJ. (Shih rastet e lartcekura të Gjykatës në rastin e ish-ndërmarrjes Agimi KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët,* të cituara më lart, paragrafi 47).

44. Në parim, palët ndërgjyqëse kanë të drejtë për një seancë dëgjimore publike, por një detyrim i tillë nuk është absolut. Për aq sa është relevante për rrethanat e tanishme, praktika gjyqësore e Gjykatës mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka zhvilluar parimet kryesore që kanë të bëjnë me (i) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë; (ii) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë dhe të tretë; (iii) parimet në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme; dhe (iv) nëse mungesa e dëgjimit në shkallën e parë mund të korrigjohet përmes një seance dëgjimore në një shkallë më të lartë dhe kriteret përkatëse për të bërë këtë vlerësim. Sidoqoftë, në të gjitha rrethanat, mungesa e një seance dëgjimore duhet të jetë e arsyetuar nga gjykata përkatëse. (Shih rastet e Gjykatës në rastin e ish-ndërmarrjes "Agimi", KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, të cituar më lart, paragrafi 48).

45. Për sa i përket çështjes së parë, përkatësisht detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë, GJEDNJ ka theksuar se në procedurat para një gjykate të shkallës së parë dhe të vetme, e drejta për një seancë dëgjimore është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Fredin kundër Suedisë (nr. 2)*, Aktgjykim i 23 shkurtit 1994, paragrafët 21-22; *Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2)*, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 46; *Göç kundër Turqisë*, Aktgjykim i 11 korrikut 2002, paragrafi 47; dhe *Selmani dhe të tjerët kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Aktgjykim i 9 shkurtit 2017, paragrafët 37-39, shih po ashtu rastet e Gjykatës, KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, , parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, të cituar më lart, paragrafi 49).

46. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përjashtim nga ky parim i përgjithshëm, përbëjnë rastet në të cilat "*ekzistojnë rrethana të*

jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore" në shkallën e parë dhe të vetme. (Shih, në këtë aspekt, rastet e GJEDNJ-së, *Hesse-Anger dhe Anger kundër Gjermanisë*, Vendim i 17 majit 2001; dhe *Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë*, Aktgjykim i 13 marsit 2018, paragrafi 36;). Karakteri i rrethanave të tilla të jashtëzakonshme buron nga natyra e çështjeve që ngërthen një rast, për shembull, rastet që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës shumë teknike. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Koottummel kundër Austrisë*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009, paragrafët 19 dhe 20).

47. Për sa i përket çështjes së dytë, përkatësisht detyrimit për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Salomonsson kundër Suedisë*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 36). Prandaj, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Miller kundër Suedisë*, Aktgjykim i 8 shkurtit 2005, paragrafi 30; dhe shih po ashtu rastet e Gjykatës, KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, të cituar më lart, paragrafi 50). Thënë këtë, dhe në parim, mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet vetëm përmes "*ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme*", siç janë definuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në të kundërtën një e tillë është e garantuar për palët në të paktën njërin nivel të juridiksionit, bazuar në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

48. Për sa i përket çështjes së tretë, përkatësisht parimeve në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme, Gjykata i referohet Aktgjykimit të 6 nëntorit 2018 të GJEDNJ-së *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, në të cilin Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së, vendosi parimet bazuar në të cilat duhet të vlerësohet domosdoshmëria e një seance dëgjimore. Sipas këtij Aktgjykimi, një seancë dëgjimore nuk është e domosdoshme nëse rasti përkatës (i) ngërthen thjeshtë çështje juridike të një natyre të kufizuar (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2)*, cituar më lart, paragrafi 49; dhe *Valová, Slezák dhe Slezák kundës Sllovakisë*, Aktgjykim i qershorit 2004, paragrafët 65-68) ose nuk ngërthen ndonjë ndërlikueshmëri të veçantë (shih, rastin e

GJEDNJ-së, *Varela Assalino kundër Portugalisë,* Vendim i 25 prillit 2002); (ii) ngërthen çështje tepër teknike, të cilat trajtohen më mirë me shkrim sesa përmes argumenteve gojore në një seancë dëgjimore; dhe (iii) nuk ngërthen çështje të besueshmërisë së palëve ose fakteve të kontestuara dhe gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme në bazë të parashtresave të palëve dhe materialeve të tjera me shkrim. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Döry kundër Suedisë*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 37; dhe *Saccoccia kundër Austrisë*, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008, paragrafi 73, shih po ashtu rastet e Gjykatës, KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, të cituara më lart, paragrafi 51).

49. Në të kundërtën, bazuar në Aktgjykimin e lartpërmendur, një seancë dëgjimore është e domosdoshme nëse rasti përkatës (i) ngërthen nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Malhous kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 60; dhe *Fischer kundër Austrisë*, Aktgjykim i 26 prillit 1995, paragrafi 44); dhe (ii) kërkon që gjykata përkatëse të fitojë një përshtypje personale për palët përkatëse, dhe t'u lejohet të njëjtëve mundësia të sqarojnë gjendjen personale, personalisht ose përmes përfaqësuesit përkatës. Shembuj të kësaj situate përbëjnë rastet kur gjykata duhet të dëgjojë prova nga palët në lidhje me vuajtjet personale në mënyrë që të përcaktojë nivelin e duhur të kompensimit (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Göç kundër Turqisë,* cituar më lart, paragrafi 51; dhe *Lorenzetti kundër Italisë*, Aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafi 33) ose duhet të sigurojë informacion në lidhje me karakterin, sjelljen dhe rrezikshmërinë e një pale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *De Tommaso kundër Italisë*, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafi 167).

50. Për sa i përket çështjes së katërt, përkatësisht mundësisë së korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë dhe kritereve respektive, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar se në parim, një korrigjim i tillë varet nga kompetencat e gjykatës më të lartë. Nëse kjo e fundit, ka juridiksion të plotë për të shqyrtuar meritat e rastit përkatës, përfshirë edhe vlerësimin e fakteve, atëherë korrigjimi i mungesës së një seance dëgjimore në shkallë të parë, mund të bëhet në shkallën e dytë. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 192 dhe referencat e përdorura aty).

51. Gjykata duke iu referuar në vazhdimësi praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës thekson se fakti që palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore nuk do të thotë që të njëjtat kanë hequr dorë nga e drejta për të mbajtur një të tillë. (Shih rastet e Gjykatës, KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, të cituar më lart, paragrafi 54, për më shumë, lidhur me heqjen dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore, shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta për një proces të drejtë, pjesa civile, IV. Kriteret Procedurale; B. Dëgjimi Publik, paragrafët 420 dhe 421 dhe referencat e përdorura aty). Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, një çështje e tillë varet nga karakteristikat e ligjit vendor dhe rrethanat e secilit rast veç e veç. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Göç kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 48).

52. Në fund, Gjykata përmbledh rrethanat faktike të rasteve të ish-ndërmarrjes "Agimi" [Aktgjykimi i Gjykatës, i 10 dhjetorit 2020 në rastet KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19], si dhe konstatimet e saja, të cilat kanë rezultuar në gjetjen e shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i mungesës së një seance dëgjimore në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së. Rrethanat e këtij rasti të sipërcekur ndërlidheshin me privatizimin e Ndërmarrjes N.Sh. "Agimi" në Gjakovë dhe të drejtat respektive të punëtorëve për t' iu njohur statusi i punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga ky privatizim, siç është përcaktuar në nenin 68 (Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime) të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe paragrafin 4 të nenit 10 të Rregullores nr. 2003/13 e të ndryshuar me Rregulloren nr. 2004/45. Parashtruesit e kërkesës nuk u përfshinë në Listën e Përkohshme të punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë pjesë nga të ardhurat e njëzet përqindëshit (20%-it) nga privatizimi i NSH "Agimi". Si rezultat i refuzimit të ankesës së tyre nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, parashtruesit e kërkesës kishin iniciuar padi në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, duke kontestuar Vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Të gjithë parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore para Kolegjit të Specializuar. Kolegji i Specializuar, kishte refuzuar kërkesën për seancë dëgjimore me arsyetimin se *"faktet dhe provat e dorëzuara janë mjaft të qarta"*, duke u dhënë të drejtë parashtruesve të kërkesës, me përjashtim të dy prej tyre, dhe duke

konstatuar se ishin diskriminuar, prandaj të njëjtit duhet të përfshihen në Listën Përfundimtare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Duke vepruar mbi bazën e ankesës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit kundër këtij Aktgjykimi, në gusht të vitit 2019, Kolegji i Apelit, kishte nxjerrë Aktgjykimin e kontestuar, përmes të cilit kishte miratuar ankesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe e kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, duke hequr "*nga lista e përfituesve të 20% nga procesi i privatizimit të NSH-së "Agimi" Gjakovë"* të gjithë parashtruesit e kërkesës. Këtë Aktgjykim, parashtruesit e kërkesës e kontestuan para Gjykatës, duke pretenduar ndër të tjera se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] me arsyetimin se Kolegji i Apelit kishte ndryshuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, (i) pa një seancë dëgjimore; (ii) pa arsyetim të mjaftueshëm; (iii) në interpretim arbitrar të ligjit; dhe (iv) në shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

53. Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës në këto raste, Gjykata u fokusua në ato që ndërlidhen me mungesën e një seance dëgjimore para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Gjykata, pas aplikimit të parimeve të lartcekura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GEJDNJ-së konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-13-0181-A0008] i 29 gushtit 2019 i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ishte nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore, ndër të tjera, sepse (i) fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tyre nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtojë me nismën e tij domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance dëgjimore; (ii) parashtruesve të kërkesës iu është mohuar e drejta e seancës dëgjimore në të dy nivelet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme; (iii) Kolegji i Apelit, nuk kishte trajtuar "*çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike*", çështje këto bazuar në të cilat do të mund të kishin ekzistuar "*rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*"; (iv) Kolegji i Apelit, në fakt, kishte shqyrtuar çështje "*fakti dhe ligji*", çështje këto shqyrtimi i të cilave, në parim, kërkon mbajtjen e një seance dëgjimore; dhe (v) Kolegji i Apelit, nuk kishte arsyetuar "*heqjen dorë nga seanca gojore*". Gjykata, po ashtu rikujton se të njëjtat parime dhe konstatime i kishte aplikuar dhe vendosur edhe në tri aktgjykime tjera në rastet e ish-ndërmarrjes "Agimi", përmes të cilave kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me

nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i mosmbajtjes së një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit.

(vii) Aplikimi i parimeve të shtjelluara më lart në rrethanat e rastit konkret

54. Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës, neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në parim, garanton mbajtjen e një seance dëgjimore në të paktën njërin nivel të vendimmarrjes. Një e tillë është, siç është sqaruar më lart, në parim, (i) e detyrueshme nëse gjykata e shkallës së parë ka kompetencën e vetme të vendimmarrjes përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit; (ii) jo e detyrueshme në shkallë në dytë nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallë të parë, përkundër faktit që një përcaktim i tillë varet nga karakteristikat e rastit përkatës, për shembull, nëse shkalla e dytë vendos edhe për çështje fakti edhe ligji; dhe (iii) e detyrueshme në shkallë të dytë nëse një e tillë nuk është mbajtur në shkallë të parë, në rastet kur shkalla e dytë ka kompetencë të plotë për të vlerësuar vendimin e shkallës së parë, edhe përkitazi me çështjet e faktit dhe të ligjit. Përjashtime nga këto raste, në parim, bëhen vetëm nëse *"ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore"*, dhe të cilat GJEDNJ, siç është sqaruar më lart, përmes praktikës së saj gjyqësore i ka përcaktuar si raste që kanë të bëjnë ekskluzivisht me çështje ligjore ose janë të natyrës së lartë teknike.

55. Bazuar në parimet e shtjelluara më lart, Gjykata në vijim fillimisht duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, fakti që parashtruesi i kërkesës nuk ka kërkuar një seancë dëgjimore as në Kolegjin e Specializuar dhe as në Kolegjin e Apelit, mund të rezultojë në konstatimin se i njëjti ka hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga një seancë dëgjimore. Nëse përgjigja në këtë çështje rezulton të jetë negative, atëherë Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret *"ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore"* në të dy shkallët e vendimmarrjes, përkatësisht para Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit, respektivisht. Këtë vlerësim Gjykata do të bëjë duke u bazuar edhe në parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, respektivisht Aktgjykimit të Dhomës së Madhe *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë,* si dhe praktikës gjyqësore të vet Gjykatës në rastet e ish-ndërmarrjes "Agimi".

e) Nëse parashtruesi i kërkesës ka hequr dorë nga e drejta e një seance dëgjimore

56. Gjykata në këtë aspekt, fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës përmes ankesës individuale të parashtruar në Kolegjin e Specializuar nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. Gjykata rikujton se Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar përmes të cilit ishte vendosur për ankesat e ish-punëtorëve të ish-Ndërmarrjes Shoqërore, të cilët nuk ishin përfshirë në Listën Përfundimtare kishte theksuar se bazuar në paragrafin 11 të nenit 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, seanca dëgjimore nuk ishte e nevojshme sepse "*faktet dhe argumentet juridike, të cilat janë ofruar janë të mjaftueshme të kjarta*".

57. Siç, është sqaruar tashmë, Kolegji i Specializuar, përmes Aktgjykimit [C-II-12-0023], bazuar në faktet dhe provat e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, kishte refuzuar ankesën e tij si të pabazuar. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të lartcekur të Kolegjit të Specializuar kishte parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit. Përkitazi me të parën, parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se (i) konstatimi i Kolegjit të Specializuar se në rastin e tij mungojnë dëshmitë për marrëdhënien e tij të punës pas 1 qershorit 1997 është "*i gabuar dhe në kundërshtim me provat e paraqitura materiale*" sepse bazuar në dëshmitë e dorëzuara vërtetohet që ai e ka filluar marrëdhënien e punës më 10 shkurt 1992, ndërsa e njëjta është ndërprerë në mars të vitit 1999 si pasojë e "*rrethanave të luftës, [...] e pas luftës për shkak të rrethanave të sigurisë dhe diskriminimit, faktikisht kam qenë në pamundësi të kryej punët e mia dhe detyrat e punës [...]";* (ii) libreza e tij e punës e bashkëngjitur si dëshmi vërteton faktin se *"nuk ka përfundim të stazhit të punës pas datës 01.06.1997*"; (iii) deklaratat e të gjithë të punësuarve në ndërmarrjen e përmendur, në cilësinë e dëshmitarëve do të konfirmonin saktësinë e pretendimeve të tij; dhe (iv) bazuar në dëshmitë që ka dorëzuar vërtetohet se i ai i plotëson kriteret e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45.

58. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përmes ankesës së tij në Kolegjin e Apelit nuk kishte kërkuar shprehimisht mbajtjen e një seance gojore. Megjithatë, bazuar në përmbajtjen e ankesës së tij, e cila në mënyrë të përmbledhur reflektohet edhe në Aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit, parashtruesi i kërkesës specifikon se *"fakti që ka punuar në NSH edhe pas datës 01 qershor 1997 mundet qartë të vërtetohet edhe me deklaratën e të gjithë të punësuarve në ndërmarrjen e cekur, gjegjësisht me dëgjimin e tyre në cilësinë e dëshmitarëve si dhe vendimit mbi themelimin e komisionit për*

regjistrim nr. 725 të datës 23 dhjetor 1998 si dhe vërtetimit të datës 25 shkurt 1999". Bazuar në përmbajtjen e këtij pretendimi specifik, të ngritur në ankesën e tij, të parashtruar në Kolegjin e Apelit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në arsyetimin e pretendimit të tij për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga Kolegji i Specializuar specifikon se vazhdimi i marrëdhënies së tij të punës edhe pas 1 qershorit 1997 mund të vërtetohet me deklaratat e ish-punonjësve të Ndërmarrjes pas dëgjimit të tyre në cilësinë e dëshmitarëve.

59. Në vijim, Gjykata duke u bazuar në shkresat e lëndës, dhe në mënyrë specifike bazuar në përmbajtjen e dy aktgjykimeve të Kolegjit të Specializuar dhe atij të Apelit nuk mund të vërejë me saktësi nëse ish-punëtorët e ish-ndërmarrjes në cilësinë e ankuesve në këtë procedurë, ankesat e të cilëve ishin trajtuar së bashku në Kolegjin e Specializuar dhe atë të Apelit të kenë parashtruar një kërkesë të tillë. Sido që të jetë, Gjykata duke u bazuar në Aktgjykimin [C-II-12-0023] e Kolegjit të Specializuar dhe Aktgjykimin e kontestuar [AC-I-17-0074-A123] të Kolegjit të Apelit vëren që këto dy instanca kishin hequr dorë nga mbajtja e një seance dëgjimore duke u referuar në nenin 68, paragrafi 11 dhe nenin 64, paragrafin 1 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, respektivisht. Në lidhje me këtë, Gjykata në mënyrë specifike ripërsëritë se Kolegji i Specializuar në Aktgjykimin e tij, përkatësisht në pjesën e përmbledhjes së fakteve dhe procedurave para këtij Kolegji kishte specifikuar se *"Aktgjykimi është nxjerr, pa mbajtur shqyrtimin publik, për shkak se faktet dhe argumentet juridike të cilat janë ofruar janë mjaftueshëm të kjarta. Kolegji nuk pret informata të tjera relevante për shqyrtim. Neni 68.11 i Aneksit te Ligjit për Dhomën e Posaçme nr. 04/L-033"*.

60. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesi në kërkesën e tij të parashtruar në Gjykatë pretendon se (i) bazuar në nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka qenë i detyruar që të mbajë seancë dëgjimore publike dhe se një detyrim të tillë e ka bazuar në këtë ligj, pa marrë parasysh nëse një kërkesë për seancë dëgjimore është paraqitur ose jo, sepse mosparaqitja e kërkesës për seancë dëgjimore nuk nënkupton domosdoshmërisht heqjen dorë nga e drejta për këtë kërkesë; (ii) Kolegji i Apelit mund të jetë liruar nga ky detyrim vetën nëse "*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat e justifikojnë mungesën e një seance dëgjimore*"; dhe (iii) Kolegji i Apelit i ka pamundësuar palëve të paraqesin dëshmitë e tyre, sepse *"asnjë rregullore nuk përcaktohet që libreza e punës është ekskluzivisht prova e vetme e ekzistencës së marrëdhënies së punës",* ndërsa kjo ishte dëshmia vendimtare bazuar në të cilën pretendimet e parashtruesit të kërkesës u refuzuan si të pabazuara, duke mos iu dhënë mundësia që siç është përcaktuar në nenin 36 (Rregullat e përgjithshme

mbi provat) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, që përmes seancës dëgjimore, të paraqet dëshmitë tjera të tij, siç janë dëshmitarët. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës iu është referuar rasteve të GJEDNJ-së, gjegjësisht rasteve *Exel kundër Republikës Çeke*, (Aktgjykim, i 5 korrikut 2005); *Gőç kundër Turqisë*, (Aktgjykim i 11 korrikut 2002); *Fredin kundër Suedisë* (nr.2) (Aktgjykim i 23 shkurtit 1994); *Allan Jacobson kundër Suedisë (*nr.2), (Aktgjykim i 19 shkurtit 1998); *Fischer kundër Austrisë* (Aktgjykim i 26 prillit 1995); *Salomonsson kundër Suedisë* (Aktgjykim i 12 nëntorit 2002).

61. Në këtë kontekst dhe ashtu siç është sqaruar më lart bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, fakti që parashtruesi i kërkesës nuk ka parashtruar kërkesë për një seancë dëgjimore në Kolegjin e Specializuar dhe shprehimisht të njëjtën kërkesë nuk e parashtruar edhe në Kolegjin e Apelit, jo detyrimisht do të thotë se i njëjti ka hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga një kërkesë e tillë, dhe gjithashtu mungesa e kësaj kërkese jodetyrimisht e liron gjykatën përkatëse, përkatësisht DHPGJS-në, nga detyrimi për mbajtjen e një seance të tillë.

62. Më saktësisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në rrethanat e rasteve në të cilat palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore, siç është rasti i parashtruesit të kërkesës, GJEDNJ, ndër të tjera, vlerëson nëse mungesa e një kërkese të tillë, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar të një parashtruesi përkatës nga e drejta për një seancë dëgjimore. Thënë këtë, mungesa e kërkesës për një seancë dëgjimore, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, asnjëherë nuk është faktori i vetëm që determinon domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance dëgjimore. Në të gjitha rastet, nëse mungesa e kërkesës për seancë dëgjimore e liron një gjykatë nga detyrimi për mbajtjen e një seance dëgjimore, varet nga (i) specifikat e ligjit të aplikueshëm; dhe (ii) rrethanat e një rasti. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Göç kundër Turqisë*, të cituar më lart, paragrafi 46). Në vijim, Gjykata do të vlerësojë këto dy kategori çështjesh.

63. Së pari, përkitazi me specifikat e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht Ligjit dhe Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Gjykata rikujton se bazuar në nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, "*Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse*", në bazë të nismës së tij apo edhe kërkesës me shkrim nga një palë. Neni 69 (Procedurat e ankesës me gojë) i Ligjit nr. 06/L-086 për DHPGJS-në, ka të njëjtën përmbajtje. Bazuar në këto dispozita, Gjykata përmes aktgjykimeve në rastet e ish–ndërmarrjes "Agimi", kishte vlerësuar se mbajtja e një seance dëgjimore,

jodetyrimisht varet nga kërkesa e palës. Bazuar në dispozitat e aplikueshme, është gjithashtu detyrë e Kolegjit përkatës, që bazuar në nismën e tij, të vlerësojë nëse rrethanat e një rasti kërkojnë mbajtjen e një seance dëgjimore. Për më tepër, përtej kompetencave të Kolegjit të Specializuar, bazuar në nenin 60 (Përmbajtja e ankesës) dhe nenin 65 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit gjithashtu ka kompetencë të vlerësojë edhe çështjet e ligjit edhe të faktit, dhe për pasojë, është e pajisur me kompetencë të plotë për të vlerësuar mënyrën se si ka vlerësuar faktet autoriteti më i ulët, përkatësisht Kolegji i Specializuar. Gjykata thekson se bazuar në nenin 64 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në dhe nenin 69 të Ligjit nr. 06/L-086 për DHPGJS-në, është detyrim i kolegjeve të DHPGJS-së, që edhe me nismën e tij të vlerësojë nëse mbajtja e një seance dëgjimore është e detyrueshme, dhe nëse jo, të arsyetoj mosmbajtjen e së njëjtës. (Shih në këtë kontekst rastet e Gjykatës në rastet e ish-ndërmarrjes "Agimi": KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, të cituara më lart, paragrafi 61).

64. Së dyti, përkitazi me rrethanat e një rasti, Gjykata rikujton që praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, thekson se mungesa e një kërkese për një seancë dëgjimore, dhe vlerësimi nëse ky fakt mund të rezultojë në konstatimin se pala përkatëse në mënyrë të nënkuptuar ka hequr dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore, duhet të vlerësohet në tërësinë e specifikave të një procedure, dhe jo si argument i vetëm, për të konstatuar nëse mungesa e një seance dëgjimore ka rezultuar ose jo në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. (Shih rastet e Gjykatës në rastin e ish-ndërmarrjes Agimi, KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, të cituara më lart, paragrafi 62).

65. Më specifikisht, në rastet kur një palë përkatëse nuk ka bërë një kërkesë për seancë dëgjimore në asnjërën nga instancat, ngjashëm si në rastin e parashtruesit të kërkesës, GJEDNJ në rastin *Salomonsson kundër Zvicrës* (Aktgjykim i 12 shkurtit 2003), në të cilin, parashtruesi përkatës nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore në asnjërën nga instancat, GJEDNJ edhe pse konstatoi se parashtruesi përkatës mund të konsiderohet se ka hequr dorë në mënyrë të nënkuptuar nga e drejta në një seancë dëgjimore (shih, paragrafin 35 të rastit të GJEDNJ-së *Salomonsson kundër Zvicrës*), megjithatë konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, sepse konstatoi që në rrethanat e rastit përkatës, nuk ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën

e një seance dëgjimore, posaçërisht marrë parasysh faktin që niveli i apelit shqyrtoi edhe çështje fakti dhe jo vetëm ligji. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Salomonsson kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafët 36-40).

66. Në anën tjetër, në rastin *Gőç kundër Turqisë*, GJEDNJ gjithashtu konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, duke refuzuar pretendimet e Qeverisë Turke se (i) rasti ishte i thjeshtë dhe se mund të trajtohej me shpejtësi vetëm në bazë të shkresave të lëndës, veçanërisht për shkak se parashtruesi përkatës përmes ankesës nuk kërkoi sjelljen e ndonjë prove të re; dhe se (ii) parashtruesi përkatës nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore. (Për faktet e rastit, shih paragrafët 11 deri 26 të rastit të GJEDNJ-së *Gőç kundër Turqisë*). Në shqyrtimin e rastit përkatës, dhe pas vlerësimit nëse në rrethanat e tij ekzistonte ndonjë rrethanë e jashtëzakonshme që do të justifikonte mungesën e një seance dëgjimore, GJEDNJ konstatoi shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, duke theksuar, ndër të tjera, se (i) përkundër faktit që parashtruesi përkatës nuk kishte bërë kërkesë për një seancë dëgjimore, nga rrethanat e rastit nuk rezulton se një kërkesë e tillë do të kishte ndonjë perspektivë suksesi; për më tepër që (ii) nuk mund të konsiderohet se parashtruesi përkatës ka hequr dorë nga e drejta e tij për një seancë dëgjimore duke mos kërkuar një të tillë para Gjykatës së Apelit pasi që kjo e fundit nuk kishte juridiksion të plotë për të përcaktuar shumën e kompensimit; (iii) parashtruesit përkatës nuk i ishte dhënë mundësia të dëgjohet as para shkallës më të ulët dhe e cila kishte kompetencë edhe për vlerësimin e fakteve edhe të ligjit; dhe (iv) çështja thelbësore, në rrethanat e këtij rasti, ishte nëse parashtruesit përkatës duhet t'i ofrohej një seance dëgjimore para një gjykate e cila ishte përgjegjëse për vërtetimin e fakteve të rastit. (Për arsyetimin e rastit përkatës, shih paragrafët 43 deri 52 të rastit *Gőç kundër Turqisë*).

67. Në vijim të kësaj, duke iu referuar rrethanave faktike dhe juridike të rastit *Gőç kundër Turqisë,* dhe duke krahasuar të njëjtat me rrethanat faktike dhe juridike të rastit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se Kolegji i Specializuar kishte hequr dorë nga mbajtja e seancës dëgjimore me arsyetimin se faktet dhe argumentet e paraqitura me shkrim ishin mjaftueshëm të qarta në mënyrë që ky Kolegj të shqyrtojë dhe vendosë në lidhje me ankesat e ish-punëtorëve të ish-ndërmarrjes, përfshirë edhe atë të parashtruesit të kërkesës. Në kontekst të këtij konstatimit të Kolegjit të Specializuar, përfshirë edhe konstatimin e ngjashëm të Kolegjit të Apelit për heqje dorë nga seanca dëgjimore, si dhe përfshirë faktin që Kolegji i Apelit kishte vërtetuar qëndrimin e Kolegjit të Specializuar për refuzimin e ankesës së parashtruesit të kërkesës kundër Vendimit të AKP-së, Gjykata

konsideron se edhe nëse parashtruesi i kërkesës do të parashtronte një kërkesë të tillë para Kolegjit të Apelit, e njëjta nuk do të kishte një perspektivë suksesi.

68. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, (i) parashtruesit të kërkesës nuk iu është dhënë mundësia të dëgjohet para Kolegjit të Specializuar, me kompetencë për vlerësimin e fakteve dhe të ligjit; (ii) Kolegji i Apelit, kishte konfirmuar se Kolegji i Specializuar në mënyrë të plotë kishte vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt kishte zbatuar ligjin e aplikueshëm.

69. Në vijim, Gjykata duke krahasuar rrethanat faktike dhe juridike të rasteve të ish-Ndërmarrjes "Agimi" (shih në mënyrë specifike rastet e Gjykatës në rastin e ish-ndërmarrjes Agimi, KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të tjerët*, të cituara më lart) me rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës gjen se këto të fundit dallojnë në aspektet si në vijim: (i) për dallim nga rasti i parashtruesit të kërkesës në rastet e ish-Ndërmarrjes "Agimi" parashtruesit e kërkesës në Kolegjin e Specializuar kishin kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore; (ii) Kolegji i Specializuar, me përjashtim të dy parashtruesve kishte aprovuar ankesën e parashtruesve të kërkesës kundër Vendimit të AKP-së për mospërfshirjen e tyre në Listën Përfundimtare, dhe kishte vendosur që të njëjtit duhet të përfshihen në Listën Përfundimtare të AKP-së; (ii) Kolegji i Apelit kishte aprovuar ankesën e AKP-së kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar dhe për pasojë kishte ndryshuar këtë të fundit duke refuzuar ankesën e të gjithë parashtruesve të kërkesë kundër Vendimit të AKP-së si të pabazuar dhe duke i hequr nga Lista Përfundimtare e AKP-së. Përderisa në rastin e parashtruesit të kërkesës, Kolegji i Specializuar kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Vendimit të AKP-së si të pabazuar, dhe për pasojë Kolegji i Apelit po ashtu kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, duke vërtetuar qëndrimin dhe konstatimin e këtij të fundit. Me gjithë faktin që Kolegji i Apelit ka vërtetuar qëndrimin dhe konstatimin e Kolegjit të Specializuar, të cilin konstatimin ky i fundit e bazon në vërtetimin e gjendjes faktike dhe zbatimit të ligjit përkatës, Gjykata vlerëson se Kolegji i Apelit për të arritur një konstatim të tillë ka shqyrtuar të gjitha faktet e paraqitura përmes ankesës fillestare të parashtruesit të kërkesës në Kolegjin e Specializuar dhe përgjigjet në ankesë të AKP-së.

70. Prandaj, përkundër dallimeve të lartcekura të rastit të parashtruesit të kërkesës me rastin e parashtruesve të kërkesës në rastet e ish-

ndërmarrjes "Agimi", të cilët kishin kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore para Kolegjit të Specializuar, Gjykata megjithatë nuk mund të konstatojë se mungesa shprehimore e parashtruesit të kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore nënkupton se i njëjti ka hequr dorë nga e drejta e tij për mbajtjen e një seance dëgjimore, të paktën në njërën nga instancat e DHPGJS-së. Për më tepër, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës si në ankesën e tij të parashtruar në Kolegjin e Apelit kishte theksuar se marrëdhënien e tij të punës edhe pas vitit 1997 mund ta dëshmonte përmes deklaratave të të gjithë të punësuarve në ndërmarrjen e përmendur, të cilët në cilësinë e dëshmitarëve, do të mund të konfirmonin saktësinë e pretendimeve të tij. në lidhje me këtë, Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata rikujton se parashtruesi në kërkesën e tij para Gjykatës pretendon se Kolegji i Apelit i ka pamundësuar palëve të paraqesin dëshmitë e tyre, sepse *"asnjë rregullore nuk përcaktohet që libreza e punës është ekskluzivisht prova e vetme e ekzistencës së marrëdhënies së punës",* ndërsa kjo ishte dëshmia vendimtare bazuar në të cilën pretendimet e parashtruesit të kërkesës u refuzuan si të pabazuara, duke mos iu dhënë mundësia që përmes seancës dëgjimore, të paraqesë dëshmitë tjera të tij, duke përfshirë dëshmitarët, siç është përcaktuar në nenin 36. Thënë këtë, Gjykata nuk mund të konstatoj se mungesa e kërkesës së parashtruesit të kërkesës për mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Apelit, mund të konsiderohet si heqje dorë e nënkuptuar e tij nga e drejta për një seancë dëgjimore, dhe posaçërisht, jo pa e vlerësuar faktin nëse në rrethanat e rastit konkret, "*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*". Kjo sepse, në të gjitha rastet në të cilat GJEDNJ kishte arritur në një konstatim të tillë, e kishte bërë në ndërlidhje me faktin se rrethanat e rasteve ndërlidheshin me çështje të natyrës ekskluzivisht ligjore ose të natyrës teknike, dhe rrjedhimisht "*ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seancë dëgjimore*". Për pasojë dhe në vijim, Gjykata duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, "*ekzistojnë rrethanat të jashtëzakonshme që do e justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*", përkatësisht nëse natyra e çështjeve në vlerësim para Kolegjit të Apelit, mund të klasifikohet si "*ekskluzivisht ligjore apo e natyrës së lartë teknike*", bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së.

f) Nëse në rrethanat e rastit konkret ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e seancës dëgjimore

71. Gjykata edhe një herë rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të vërtetuar edhe me praktikën gjyqësore të vet Gjykatës palët kanë të drejtë në seancë dëgjimore në të paktën njërën instancë.

Kjo instancë, është kryesisht instanca e parë, dhe ajo e cila e ka juridiksionin për të vendosur edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji (shih rastet e Gjykatës në lidhje me ish-Ndërmarrjen Agimi, KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues *E'them Bokshi dhe të tjerët*, të cituara më lart, paragrafi 69). Në këtë kontekst, përkitazi me detyrimin për të mbajtur një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë ose të tretë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se mungesa e një seance dëgjimore mund të justifikohet bazuar në karakteristikat e veçanta të rastit përkatës, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallë të parë. Në parim, nëse një seancë dëgjimore është mbajtur në shkallën e parë, procedurat para gjykatave të apelit, dhe të cilat përfshijnë vetëm çështje të ligjit, dhe jo çështje fakti, mund të konsiderohen të jenë në përputhje me garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së, edhe nëse në shkallë të dytë nuk është mbajtur një seancë dëgjimore. Thënë këtë, përjashtim nga e drejta për një seancë dëgjimore, janë vetëm ato raste, në të cilat përcaktohet se "*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*". Këto rrethana, siç është sqaruar më lart, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së i ka klasifikuar si raste të cilat ndërlidhen me "*çështje ekskluzivisht ligjore apo të natyrës së lartë teknike*". (Shih rastin *Schüler-Zgraggen kundër Zvicrës, të cituar më lart* dhe *Döry kundër Suedisë*, të cituar më lart).

72. Në mënyrë të ngjashme, GJEDNJ vepron edhe në ato raste në të cilat çështjet para Gjykatës përkatëse janë ekskluzivisht ligjore, dhe nuk përfshijnë vlerësimin e fakteve kontestuese. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë,* të cituar më lart, paragrafi 78).

73. Përkundrazi në raste tjera e në të cilat, GJEDNJ përcaktoi se çështjet para gjykatave përkatëse ngërthenin edhe çështje fakti edhe ligji, ajo nuk konstatoi se "*ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*". Për shembull, në rastin *Malhous kundër Republikës Çeke* (Aktgjykim i 12 korrikut 2001), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, pasi përcaktoi se çështjet për të cilat ankohej parashtruesi përkatës nuk ngërthenin vetëm çështje ligji por edhe fakti, përkatësisht vlerësimin nëse autoriteti më i ulët i kishte vlerësuar faktet në mënyrë të drejtë. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Malhous kundër Republikës Çeke*, cituar më lart, paragrafi 60). Në të njëjtën mënyrë, në rastin *Koottummel kundër Austrisë* (Aktgjykim i 10 dhjetorit 2009), GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për mungesë të një seance dëgjimore, sepse konstatoi së çështjet para saj nuk mund të kualifikoheshin si çështje të natyrës ekskluzivisht ligjore

ose të natyrës teknike, që do të mund të konsistonin në rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Koottummel kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafët 20 dhe 21).

74. Ngjashëm, si në rrethanat e rasteve të lartcituara të GJEDNJ-së *Malhous kundër Republikës Çeke* dhe *Koottummel kundër Austrisë*, Gjykata duke aplikuar këtë qëndrim të GJEDNJ-së edhe në rrethanat e rastit konkret konsideron se Kolegji i Apelit, ka juridiksion edhe për çështje fakti edhe për çështje ligji. Bazuar në paragrafin 11 të nenit 10 (Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet) të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Ligji për DHPGJS-në) dhe paragrafin 4 të nenit 64 (Procedurat e ankesës me gojë) dhe nenin 65 (Paraqitja e provave të reja) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, palët, ndër të tjera, kanë mundësinë që të ngritin ankesat para Kolegjit të Apelit edhe përkitazi me çështjet e ligjit edhe të fakteve, duke përfshirë edhe mundësinë që të paraqiten prova të reja.

75. Gjykata më tej vëren, se bazuar në nenin 68 të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-në, në rast të ankesave lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, barra e provës bie mbi parashtruesit e kërkesës përkatëse para Kolegjit të Specializuar. Po ashtu, barra e të provuarit për kundërshtuesin e një kërkese të tillë, bie mbi kundërshtuesin, përkatësisht AKP-në, në rrethanat e rastit konkret. Para Kolegjit të Apelit, barra e të provuarit gjithashtu bie mbi parashtruesin e ankesës përkatëse. Rrethanat e rastit konkret, gjithashtu, në esencë ndërlidhen me pretendime për diskriminimin. Këtë pretendim të tij, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit të tij e kishte refuzuar për arsye se parashtruesi i kërkesës nuk ishte ngritur në procedurë para Kolegjit të Specializuar. Në rast të pretendimeve për diskriminim , barra e të provuarit, bazuar në nenin 8 (Barra e Provave) të Ligjit kundër Diskriminimit, bie mbi palën e paditur, përkatësisht AKP-në, dhe jo parashtruesin e kërkesës. (Shih, rastet e Gjykatës KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, të cituar më lart, paragrafi 76) .

76. Në rrethana të tilla dhe duke aplikuar qëndrimin e GJEDNJ-së në rastet *Malhous kundër Republikës Çeke* dhe *Koottummel kundër Austrisë* dhe praktikën gjyqësore në rastet e ish-ndërmarrjes "Agimi", Gjykata thekson se: (i) Kolegji i Apelit ka shqyrtuar edhe çështje fakti edhe ligji; (ii) dhe përkitazi me faktet, barra e të provuarit se i plotësojnë kriteret e paragrafit 4 të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-

ut nr. 2003/13, në parim bie mbi parashtruesin e kërkesës. Për pasojë, Gjykata vlerëson se është e pakontestueshme që çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk është (i) as çështje ekskluzivisht ligjore; dhe (ii) as e natyrës teknike. Përkundrazi, çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit ngërthente çështje të rëndësishme faktike dhe ligjore. Për pasojë, Gjykata duhet të konstatojë, se në rrethanat e rastit konkret, nuk ekzistojnë rrethana të cilat do e justifikonin mungesën e seancës dëgjimore.

77. Në mbështetje të këtij konstatimi, Gjykata rikujton se Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, dhe të cilit iu ishte referuar edhe në rastet e ish-ndërmarrjes "Agimi", specifikisht kishte përcaktuar se një seancë dëgjimore është e domosdoshme në rrethana që ngërthejnë nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë. Kjo vlen posaçërisht në rrethana në të cilat, një seancë dëgjimore nuk është mbajtur as para shkallës më të ulët, siç është rasti në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës.

78. Në fund, Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se Kolegji i Apelit nuk kishte arsyetuar "*heqjen dorë nga seanca*", por ishte mjaftuar vetëm me referimin në paragrafin 1 të nenit 64 të Shtojcës se Ligjit për DHPGJS-në. Ky i fundit, siç është sqaruar më lart, thjesht përcakton kompetencën e Kolegjit të Apelit për të vendosur për mbajtjen e seancës dëgjimore bazuar në nismën e tij ose me kërkesë të palës. Aktgjykimi përkatës nuk përmban asnjë sqarim shtesë lidhur me vendimin e Kolegjit të Apelit për të *"hequr dorë nga seanca"*. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me mungesën e një seance dëgjimore, duhet të shqyrtohet edhe nëse refuzimi i mbajtjes së një seance të tillë është i arsyetuar.

79. Prandaj, dhe në përfundim, Gjykata, duke marrë parasysh që (i) fakti që parashtruesi i kërkesës nuk ka kërkuar shprehimisht mbajtjen e një seance dëgjimore në nivel të Kolegjit të Specializuar dhe atij të Apelit, nuk nënkupton se i njëjti në mënyrë të nënkuptuar ka hequr dorë nga kjo e drejtë, posaçërisht duke marrë parasysh që i njëjti e ka iniciuar ankesën para Kolegjit të Apelit. (ii) Gjithashtu se mungesa e kësaj kërkese, nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi për vlerësimin e domosdoshmërisë së një seance dëgjimore, për më tepër për faktin se parashtruesi në ankesën e tij para këtij Kolegji kishte specifikuar se marrëdhënia e tij e punës në ndërmarrje pas vitit 1997 mund të dëshmohej me dëshminë e ish-punonjësve të kësaj ndërmarrje, në cilësi të dëshmitarëve; (iii) se edhe nëse parashtruesi i kërkesës të

kishte paraqitur një kërkesë të tillë, e njëjta mund të rezultonte në mungesë perspektivës për sukses; (iv) çështjet në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk mund të kualifikohen as si çështje ekskluzivisht ligjore dhe as çështje të natyrës teknike, por përkundrazi si çështje të faktit dhe ligjit, dhe vlerësimi i të cilave, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJENDJ-së, ngërthejnë domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance dëgjimore të paktën në një nivel juridiksioni; dhe (iv) Kolegji i Apelit nuk e kishte arsyetuar "*heqjen dorë nga seanca*", konstaton se në rastin konkret nuk kanë "*ekzistuar rrethana të jashtëzakonshme për të justifikuar mungesën e një seance dëgjimore*", dhe për pasojë, Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-17-0074-A123] i 8 tetorit 2019 i Kolegjit të Apelit, përkitazi me parashtruesin e kërkesës, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

80. Në vijim, Gjykata duke ju referuar pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së, dhe nenin 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, në kontekst të të cilit pretendon se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë në raport me tre ish-punonjës të Ndërmarrjes Shoqërore [K.B. me numër të lëndës [C-0026] dhe S.B. me numër të lëndës [C-0029] në Kolegjin e Specializuar dhe D.V. [me numër të lëndës [C-0004] në Kolegjin e Specializuar dhe numër të lëndës [A-001] në Kolegjin e Apelit] në bazë të dosjes së lëndës verën se si në rastin e parashtruesit të kërkesës ashtu edhe të tre ish-punonjësve të lartcekur të Ndërmarrjes Shoqërore, Kolegji i Apelit të DHPGJS përmes Aktgjykimit të kontestuar ankesën e këtyre tre ish-punonjësve e kishte refuzuar si të pabazuar.

81. Megjithatë, Gjykata, duke marrë parasysh që tashmë ka konstatuar që Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së një seance dëgjimore, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohet pretendimi i lartcekur për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së, dhe nenin 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ- së, pasi që i njëjti mund të adresohet dhe shqyrtohen nga Kolegji i Apelit. Gjithashtu edhe në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me mungesën e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe pretendimin përkitazi me shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, Gjykata konsideron se këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Për më tepër, duke marrë parasysh që Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë

për të shqyrtuar vendimet e kontestuara të Kolegjit të Specializuar bazuar në ligjet e aplikueshme për DHPGJS-në, i njëjti ka mundësinë e korrigjimit në shkallë të dytë të mungesës së një seance dëgjimore në shkallën e parë.

82. Konstatimi i Gjykatës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet ekskluzivisht me mungesën e seancës dëgjimore, siç është sqaruar në këtë Aktgjykim, dhe në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me dhe as nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit. (Shih në mënyrë të ngjashme rastet e Gjykatës, KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues *E'them Bokshi dhe të tjerët*, të cituara më lart, paragrafi 83).

Kërkesa për masë të përkohshme

83. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës parashtroi para saj kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme pa saktësuar se çfarë procedure apo veprimi duhet të pezullohet përmes vendosjes së masës së përkohshme.

84. Gjykata tashmë konstatoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të deklarohet e pranueshme dhe të konstatohet se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht kjo vendimmarrje e bën më tutje të panevojshme shqyrtimin e kërkesës për masë të përkohshme. (Shih rastin e Gjykatës KI207/19, parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë,* Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 237).

Përfundimi

85. Gjykata, në rrethanat e këtij rasti, ka vlerësuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me mungesën e seancës dëgjimore, e drejtë kjo e garantuar, sipas sqarimeve të këtij Aktgjykimi, përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

86. Në vlerësimin e pretendimeve përkatëse, Gjykata fillimisht ka shtjelluar parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës në 5 (pesë) aktgjykimet e saj në rastet e ish-ndërmarrjes "Agimi" përkitazi me të drejtën në një seancë dëgjimore, duke i sqaruar rrethanat në të cilat një e tillë është e domosdoshme, bazuar ndër të tjera, në Aktgjykimin e Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër*

Portugalisë. Gjykata ka sqaruar, ndër të tjera, se (i) mungesa e kërkesës së një pale për seancë dëgjimore jo detyrimisht nënkupton heqjen dorë nga një e drejtë të tillë dhe se vlerësimi i ndikimit të mungesës së një kërkese të tillë varet nga specifikat e ligjit dhe rrethanat e veçanta të një rasti; dhe (ii) në parim, palët kanë të drejtë në një seancë dëgjimore në të paktën një nivel të juridiksionit, përpos nëse "*ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*", e të cilat bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim ndërlidhen me raste në të cilat shqyrtohen "*çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike*".

87. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se (i) fakti që parashtruesi i kërkesës nuk ka kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Specializuar dhe atij të Apelit, nuk nënkupton heqjen dorë të tij nga kjo e drejtë dhe as nuk e liron Kolegjin e Apelit nga detyrimi që të trajtojë me nismën e tij domosdoshmërinë e mbajtjes së një seance dëgjimore; (ii) Kolegji i Apelit, nuk kishte trajtuar "*çështje ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike*", çështje këto bazuar në të cilat do të mund të kishin ekzistuar "*rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonin mungesën e një seance dëgjimore*", por përkundrazi, kishte shqyrtuar edhe çështje fakti edhe ligji; dhe (iii) Kolegji i Apelit nuk kishte arsyetuar "*heqjen dorë nga seanca gojore*". Duke marrë parasysh këto rrethana dhe arsyetimet e tjera të dhëna në këtë Aktgjykim, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-I-17-0074-A123] i 8 tetorit 2019, i Kolegjit të Apelit, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore.

88. Përfundimisht, Gjykata gjithashtu theksoi se (i) bazuar në ligjin e aplikueshëm për DHPGJS-në, Kolegji i Apelit ka kompetencë të plotë për vlerësimin e vendimeve të Kolegjit të Specializuar dhe rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës, ka mundësinë e korrigjimit të mungesës së seancës dëgjimore në nivelin e gjykatës më të ulët, përkatësisht, Kolegjit të Specializuar; (ii) nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me mungesën e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe pretendimet përkitazi me shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së, dhe nenin 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së dhe nenin 49 të Kushtetutës sepse të njëjtat duhet të shqyrtohen nga Kolegji i Apelit në përputhshmëri me konstatimet e këtij Aktgjykimi; dhe (iii) konstatimi i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret ndërlidhet vetëm me garancitë procedurale për një

seancë dëgjimore dhe në asnjë mënyrë nuk e paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 57 dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 29 korrik 2021, me shumicë votash:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se përkitazi me parashtruesin e kërkesës ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-I-17-0074-A123] e 8 tetorit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme përkitazi me parashtruesin e kërkesës;

IV. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

V. TË KTHEJË çështjen në rivendosje në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në përputhje me konstatimet e këtij Aktgjykimi;

VI. TË URDHËROJË Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës deri më 24 janar 2022;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Gresa Caka-Nimani

KI64/21, Parashtruese: Ali Gjonbalaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 1848/17, të 11 gushtit 2020

KI64/21, Aktvendim i 29 korrikut 2021, publikuar më 31 gusht 2021

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme

Parashtruesi i kërkesës kishte filluar një kontest lidhur me një ngastër dhe një mur në gjykatat e rregullta. Ai kërkoi që personi përkatës (ii) t'i dorëzoj në shfrytëzim të papenguar sipërfaqen prej 24 m2, pjesë e ngastrës kadastrale; (ii) të rrënojë në tërësi murrin e ndërtuar në gjatësi prej 8.94 m, gjerësi 25 cm dhe lartësi 2m; dhe (iii) të përmbahet nga çfarëdo shqetësimi.

Gjykata Themelore vendosi që të refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, dhe këtë qëndrim e mbështeti dhe Gjykata e Apelit. Parashtruesi i kërkesës, parashtroi edhe propozimin për inicimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, por ky i fundit gjeti se propozimi i parashtruesit të kërkesës nuk aprovohet.
Parashtruesi i kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese pretendon shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm duke kontestuar qëndrimet e Gjykatës së Apelit dhe gjendjen faktike të vërtetuar nga kjo e fundit.

Gjykata duke u bazuar në faktin që parashtruesi i kërkesës (i) shprehimisht konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, dhe (ii) nuk paraqet pretendime specifike që kanë të bëjnë me arsyet e dhëna nga Njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe se si Njoftimi i kësaj të fundit për të mos paraqitur kërkesë për mbrojte të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme kishte cenuar të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës, konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [nr.1848/17] të 2 tetorit 2020, është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.

Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës. Përfundimisht, Gjykata konstaton që kërkesa është e papranueshme në baza kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI64/21

Parashtrues

Ali Gjonbalaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 1848/17, të 11 gushtit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ali Gjonbalaj nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Ymer Koro nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 1848/17, të 11 gushtit 2020.

3. Parashtruesi i kërkesës, vendimin e kontestuar, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 1848/17, të 11 gushtit 2020, e ka pranuar më 2 tetor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me paragrafin 2 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe

Instrumenteve Ndërkombëtare], dhe paragrafin 1 e 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 29 mars 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), e të cilën kjo e fundit e pranoi më 31 mars 2021.

7. Më 7 prill 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

8. Më 12 prill 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Gjykata në të njëjtën ditë (i) njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e lëndës, dhe njëkohësisht (ii) kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren, që të dorëzonte *fletëkthesën* që dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin Ac.nr. 1848/17, të 11 gushtit 2020 të Gjykatës së Apelit.

9. Më 29 prill 2021, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore në Prizren, fletëkthesën e cila dëshmon se parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin [Ac.nr. 1848/17] të 11 gushtit 2020 të Gjykatës së Apelit, e ka pranuar më 2 tetor 2020.

10. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr

pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

11. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

12. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama–Hajrizi, përmes Vendimit Nr. KI64/21, caktoi gjyqtarin Safet Hoxha si Gjyqtar raportues në vend të Gjyqtarit Bekim Sejdiu pas dorëheqjes së tij.

13. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

14. Më 29 korrik 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Parashtruesi i kërkesës dhe personi Z.T janë fqinjë dhe që të dy jetojnë në Prizren. Nga shkresat e lëndës, rezulton që kontesti mes tyre lind për shkak të një ngastre me sipërfaqe prej 24 m2, dhe një muri ndarës në këtë sipërfaqe i ndërtuar në vitin 1981, kur në patundshmërinë e tani parashtruesit të kërkesës (e blerë në vitin 2000), jetonin pronarë tjerë.

16. Më 5 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës paditi personin Z.T në Gjykatën Themelore në Prizren, duke kërkuar të obligohet që personi Z.T që parashtruesit të kërkesës (i) t'i dorëzoj në shfrytëzim të papenguar sipërfaqen prej 24 m2, pjesë e ngastrës kadastrale nr.3121 ZK Prizren; (ii) të rrënojë në tërësi murin e ndërtuar në lartësi prej 8.94 m, gjerësi 25 cm dhe lartësi 2m; dhe (iii) të përmbahet nga çfarëdo shqetësimi.

17. Më 30 janar 2017, Gjykata Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit C.nr.719/2013, (i) refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar; dhe (ii) aprovoi kundër-kërkesëpadinë e personit Z.T, përmes të cilës u

vërtetua se i njëjti në bazë të parashkrimit fitues është pronar i paluajtshmërisë me sipërfaqen prej 24 m2, pjesë e ngastrës kadastrale nr.3121 ZK Prizren dhe murin kufizues në lartësi prej 8.94 m, gjerësi 25 cm dhe lartësi 2m, dhe njëkohësisht obligoi parashtruesin e kërkesës që t'ia pranojë këtë të drejtë personit Z.T, dhe të lejojë regjistrimin e kësaj sipërfaqe në librat kadastral.

18. Në një datë të pacaktuar parashtruesi i kërkesës parashtron ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C.nr.719/2013, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

19. Më 11 gusht 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit Ac.nr.1848/17, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore C.nr.719/2013 të 30 janarit 2017. Gjykata e Apelit, vlerësoi se Gjykata Themelore, ka vërtetuar drejtë gjenden faktike dhe ka vendosur drejtë mbështetur në dispozitat materiale, përkatësisht në nenin 25 e 28 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (në tekstin e mëtejmë: LMTHJP).

20. Më 30 janar 2021, parashtruesi i kërkesës parashtroi propozimin për inicimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

21. Më 28 dhjetor 2020, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit KMLC.nr. 178/2020, gjeti se propozimi i parashtruesit të kërkesës nuk aprovohet sepse *"pretendimet e cekura në propozimin tuaj nuk janë të mjaftueshme për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 247.1 pika a) dhe b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar [Ac.nr. 1848/17] të 11 gushtit 2020 të Gjykatës së Apelit, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me paragrafin 2 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], dhe paragrafin 1 e 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

23. Përkitazi me shkeljet e pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson se *"Meqenëse Gjykatësi në këtë çështje juridike ka zbatuar dispozitat e [LMTHJP], atëherë sipas nenit 20 të të njëjtit ligj, [parashtruesi i kërkesës], në bazë të ligjit (Kontratës së përmendur), është bërë pronar legjitim i parcelës kontestuese me të gjitha dimenzionet që kanë ekzistuar në kadastër, ku përfshihet edhe sipërfaqja kontestuese prej 24m 2."*

24. Parashtruesi i kërkesës poashtu thekson *"[...] kopja e planit të datës 10.02.1983, muri kontestues në p.k.r. 3121 nuk ka ekzistuar, kurse në kopjen e planit të datës 24.11.2000 paraqitet ekzistimi i murit kontestues dhe se kjo kopja e planit të vitit 2000, në tërësi përputhet me deklaratën e dëshmitarëve të cilët paraqesin se muri kontestues nga ana e të padituri është ndërtuar në p.k.nr 3121 në vitin 1999".*

25. Parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar dhe çështjes së parashkrimit fitues thekson se parashkrimi është i ligjshëm nëse ekziston baza ligjore për fitimin e pronësisë sipas nenit 20 të LMTHJP-së, ose që nuk është fituar me mashtrim e keqpërdorim besimit. Në rastin konkret ai mendon se personi Z.T, ngastrën kontestuese nuk e ka përfituar me asnjë bazë ligjore. Në këtë pikë, parashtruesi i kërkesës pohon se edhe neni 28 i LMTHJP është i gabuar.

26. Parashtruesi i kërkesës konteston qëndrimet e Gjykatës së Apelit dhe thekson se *"nuk janë të vërteta konstatimet e Gjykatës së Apelit se paditësi nuk ka kundërshtuar ndërtimin e murrit dhe se dëshmitarët kinse kanë pohuar se murri ka ekzistuar që nga viti 1981[....]. Gjykata e Apelit konstaton gabimisht se i padituri ndërtimin e këtij murri e ka rregulluar me ish pronarin[...].*

27. Parashtruesi i kërkesës, poashtu thekson se Gjykata e Apelit, në faqen 6 *"gabimisht konstaton se kinse i padituri është në posedim të murrit prej vitit 1998 [...] Gjykata e Apelit gabimisht ka llogaritur, sepse prej 1998 e deri në vitin 2013, dallimi është 15 vite e jo 20 vite [...]*

28. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të (i) shpallë kërkesën e tij të pranueshme, dhe të konstatojë shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (ii) të shpallë të pavlefshëm Njoftimin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit KMLC nr. 178/2020 të 28 dhjetorit 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AC.nr. 1848/17 të 11 gushtit 2020 (iii) Të kthejë çështjen kontestuese në Prokurorinë Shtetërore apo Gjykatës së Apelit në ri-shqyrtim dhe

të njëjtat t'i urdhërojë që brenda afatit prej 6 muajsh të njoftojnë Gjykatën për masat e ndërmarra.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2.Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

2. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

LIGJI MBI MARRËDHËNIET THEMELORE JURIDIKE-PRONËSORE

Neni 20

1. *E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim.*
2. *E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj.*

[...]

Neni 25

1. *Në qoftë se ndërtuesi ka ditur se po ndërton në tokën e huaj apo nëse këtë nuk e ka ditur, kurse pronari këtë menjëherë e ka kundërshtuar, pronari i tokës mund të kërkojë që t'i takojë e drejta e pronësisë mbi objektin ndërtimor ose që ndërtuesi të rrëzojë objektin ndërtimor dhe t'ia kthejë tokën në gjendjen e mëparshme ose që ndërtuesi t'ia paguajë tokën sipas çmimit të qarkullimit.*
   [...]

8. *Këtë kërkesë pronari mund ta paraqesë brenda afatit prej tre vjetësh nga dita e përfundimit të ndërtimit të objektit ndërtimor.*

[...]

Neni 28

1. *Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fituese me kalimin e kohës prej tre vjetësh.*
2. *Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.*
3. *Mbajtësi me mirëbesim i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.*
4. *Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.*

5. *Trashëgimtari bëhet mbajtës me mirëbesim nga momenti i hapjes së trashëgimisë edhe në rastin kur trashëgimlënësi ka qenë mbajtës me keqbesim, e trashëgimtari këtë nuk e ko ditur as që ka mundur ta dinte kurse koha për parashkrimin fitues fillon të ece nga momenti i hapjes së trashëgimisë.*

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 247

247.1 Prokurori publik mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë:

a) për shkak te shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale , po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore;

b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

247.2 Prokurori publik nuk mundë të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të kapërcimit të kërkesë-padisë dhe as për shkak të vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

31. Gjykata në vazhdim i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, që përcakton:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

32. Gjykata shqyrton gjithashtu nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], respektivisht paragrafët (1) (b) dhe (c) të Rregullores së punës. Ato përcaktojnë si në vijim:

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

Rregulli 39 i Rregullores së punës
[Kriteret e pranueshmërisë]

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]
b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar;
c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe
[...]."

33. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik. Gjykata ka parasysh që është nxjerrë një Njoftim i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit KMLC nr. 178/2020 i 28 dhjetorit 2020, megjithatë vëren se parashtruesi i kërkesës në mënyrë eksplicite konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 1848/17, të 11 gushtit 2020. Vetë parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pranë Gjykatës thekson se *"Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AC.nr.1848/17 të datës 11.08.2020[...]"*. Andaj Gjykata do vlerësojë, se a është i njëjti i dorëzuar në afatin e përcaktuar me Ligj e Rregullore.

34. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se si rregull, afati 4 (katër) mujor fillon nga *"vendimi i fundit"* në procesin e shterjes së mjeteve juridike me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës (shih *mutatis mutandis,* rastet e GJEDNJ-së, *Gavrilov kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Vendim i 1 korrikut 2014, paragrafi 25; dhe *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendim i 14 marsit 2002 si dhe shih rastin e Gjykatës KI174/20 *parashtrues "DE-KO" Sh.p.k,* Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2021, paragrafi 32).

35. Gjykata rikujton po ashtu se parashtruesi i kërkesës duhet t'i shterojë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë efektive dhe të mjaftueshme. Vetëm mjetet efektive mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi parashtruesi i kërkesës nuk mund të zgjasë afatet kohore strikte të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës, duke u përpjekur të ushtrojë mjete juridike të cilat nuk janë efektive që të ofrojnë mbrojtje të të drejtave për të cilat ankohet parashtruesi i kërkesës (shih, *mutatis mutandis,* rastet e GJEDNJ-së, *Gavrilov kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, cituar më lart, paragrafi 25; dhe, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendim i 5 janarit 2006). Lidhur me kriteret e lartcekura, Gjykata vlerëson fillimisht se kërkesa për shterjen e mjeteve juridike dhe kriteri që kërkesa të paraqitet brenda afatit prej 4 (katër) muajve janë të ndërlidhura ngushtësisht (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Jeronovičs kundër Latvisë, Aktgjykim i 6 qershorit 2016, paragrafi 75,* KI174/20 *parashtrues "DE-KO" Sh.p.k,* cituar më lart, paragrafi 33*)*.

36. Megjithatë, në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk paraqet pretendime specifike që kanë të bëjnë me arsyet e dhëna nga Njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe se si Njoftimi i kësaj të fundit për të mos paraqitur kërkesë për mbrojte të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme kishte cenuar të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës. Pretendimet e parashtruesit në kërkesën e tanishme

ndërlidhen në mënyrë shprehimore me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, dhe me pohimet se kjo e fundit përmes Aktgjykimit të saj Ac.nr. 1848/17, të 11 gushtit 2020 në esencë (i) ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike, referuar kështu çështjes ndërtimit murit dhe mënyrës se si është poseduar ngastra kontestuese; dhe (ii) si është zbatuar e drejta materiale, përkatësisht LMTHJP.

37. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [Ac.nr.1848/17] ishte nxjerrë më 11 gusht 2020 dhe ishte pranuar nga parashtruesi i kërkesës më 2 tetor 2020, vërtetuar kjo edhe me fletëkthesën e dërguar nga Gjykata Themelore në Prizren. Parashtruesi i kërkesës, në anën tjetër, ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë përmes postës më 29 mars 2021. Rrjedhimisht, rezulton që kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [nr.1848/17] të 2 tetorit 2020, është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.

38. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-se: *Franz Hofstiidter kundër Austrisë*, kërkesa nr. 25407/94, Vendim i 12 shtatorit 2000; *Olivier Gaillard kundër Francës*, kërkesa nr. 47337/99, Vendim i 11 korrikut 2000; shih gjithashtu, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI140/13, me parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24; dhe KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 39).

39. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, nëse përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit janë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 e 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 29 korrik 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Safet Hoxha	Gresa Caka-Nimani

AKTVENDIM PËR MOSPËRMBARIM

lidhur me

AKTGJYKIMIN
e
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

të 22 shtatorit 2010

në

rastin nr. KI56/09

parashtruesit

Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë

kundër

Kuvendit Komunal të Prizrenit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Objekti i çështjes:

1. Bazuar në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 19 (Marrja e vendimeve) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 66 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës nr. 01/2018 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës), objekti i çështjes është: (i) vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese të

Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), përkitazi me zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI56/09, me parashtrues *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë*, Aktgjykim i 22 shtatorit 2010 (në tekstin e mëtejmë: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI56/09), nga ana e autoriteteve përgjegjëse të Republikës së Kosovës; dhe (ii) vendimmarrja e Gjykatës përkitazi me Aktvendimin për Mospërmbarim dhe Njoftimin përkatës për Prokurorin e Shtetit, siç është përcaktuar në paragrafët (6) dhe (7) të Rregullit 66 të Rregullores së punës.

Baza juridike për nxjerrjen e Aktvendimit për Mospërmbarim dhe Njoftimin e Prokurorit të Shtetit:

2. Gjykata fillimisht do të citojë, e më pas elaborojë, bazën juridike për nxjerrjen e këtij Aktvendimi për Mospërmbarim dhe lëshimin e Njoftimit për Prokurorin e Shtetit përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI56/09. Në vijim, dispozitat relevante të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 116
[Efekti Juridik i Vendimeve]

1. *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.*

[...]

Ligji për Gjykatën Kushtetuese

Neni 19
(Marrja e vendimeve)

1. *Gjykata Kushtetuese vendos si trup gjykues i përbërë prej të gjithë gjyqtarëve të pranishëm të Gjykatës Kushtetuese.*
2. *Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë (7) gjyqtarë.*
3. *Gjykata Kushtetuese merr vendime me shumicën e votave të gjyqtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.*

[...]

Rregullorja e punës

Rregulli 66
(Zbatimi i vendimeve)

(1) Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe për institucionet e Republikës së Kosovës.
(2) Të gjitha organet kushtetuese, si dhe gjykatat e autoritetet, janë të obliguara të respektojnë, të jenë në përputhje dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës, brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.
(3) Të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të respektojnë vendimet e Gjykatës dhe t'u përmbahen atyre.
(4) Gjykata mund të specifikojë, në vendimin e saj, mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e vendimit të Gjykatës.
(5) Organi i obliguar për të zbatuar vendimin e Gjykatës do të dorëzojë informatat, nëse kërkohet dhe ashtu siç kërkohet me vendim, për masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit të Gjykatës.
(6) Në rast të moszbatimit të një vendimi, ose të vonesës në dhënien e informacioneve për Gjykatën për masat e ndërmarra, Gjykata mund të lëshojë një aktvendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar. Ky aktvendim publikohet në Gazetën Zyrtare.
(7) Prokurori i Shtetit informohet për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar.
(8) Sekretariati, nën mbikëqyrjen e gjyqtarit, i cili në pajtim me rregullin 58 e ka hartuar vendimin, do ta përcjellë zbatimin e vendimit, si dhe, sipas nevojës, do t'i raportojë Gjykatës me rekomandimin për procedurat e mëtejmë ligjore që duhet të ndërmerren.

3. Baza e lartcekur ligjore paraqet rregullimin kushtetues dhe ligjor mbi të cilin Gjykata është e autorizuar të ndërmarrë veprime përkitazi me monitorimin e zbatimit të Aktgjykimeve të saj dhe masat përkatëse në rast të konstatimit të moszbatimit të tyre.

4. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, vendimet e saj janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Për më tepër, bazuar në të njëjtin nen të Kushtetutës në lidhje me rregullin 66 të Rregullores së punës: (i) të gjitha organet kushtetuese, si dhe gjykatat e autoritetet, janë të obliguara të respektojnë, të jenë në përputhje dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës, brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj; dhe (ii) të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të respektojnë vendimet e Gjykatës dhe t'u përmbahen atyre.

5. Gjykata gjithashtu thekson se bazuar në rregullin 66 të Rregullores së punës, Gjykata mund të specifikojë në vendimin e saj: (i) mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e vendimit të Gjykatës; (ii) organet e obliguara për të zbatuar vendimin e Gjykatës dhe të dorëzojnë informatat, nëse kërkohet dhe ashtu siç kërkohet me vendim, për masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit të Gjykatës; (iii) në rast të moszbatimit të një vendimi, ose të vonesës në dhënien e informacioneve për Gjykatën për masat e ndërmarra, Gjykata mund të lëshojë një Aktvendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar dhe të publikojë këtë qëndrim në Gazetë Zyrtare; dhe (iv) të informojë Prokurorin e Shtetit për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar.

6. Bazuar në paragrafin (8) të rregullit 66 të Rregullores së punës, Gjykata përmes mekanizmave të saj përcjellë zbatimin e vendimeve dhe mund të ndërmarrë procedura të mëtejmë ligjore. Vlerësimi i zbatimit të vendimeve të Gjykatës bëhet në mënyrë periodike dhe në rast të konstatimit se një vendim nuk është zbatuar, Gjykata nxjerrë Aktvendim për Mospërmbarim dhe njofton Prokurorin e Shtetit.

7. Në këtë kontekst, Gjykata ka ndërmarrë masat e përcaktuara në Rregulloren e saj të punës përkitazi me Aktgjykimet: (i) në rastin KO01/09, të 18 marsit 2010, me parashtrues *Qemail Kurtishi* (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KO01/09), duke lëshuar Urdhrin e 7 qershorit 2010 dhe Urdhrin e 21 qershorit 2021[2]; (ii) në rastin KI08/09, të 17 dhjetorit 2010, me parashtrues *Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK,* në Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI08/09), duke nxjerrë Vendim për Mospërmbarim dhe e kishte njoftuar Prokurorin e Shtetit[3]; (iii) në rastin KI112/12, të 5 korrikut 2013, me parashtrues *Adem Meta* (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI112/12), duke iu drejtuar me shkresë Kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe duke e

---

[2] Shih Urdhrin në rastin KO01/09, të 7 qershorit 2010, i qasshëm përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/urdher_rasti_ko_01_09.pdf dhe Urdhrin në rastin KO01/09, të 21 qershorit 2010, i qasshëm përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/urdher_rasti_ko_01_09.pdf

[3] Shih Vendimin për Mospërmbarim të Aktgjykimit në rastin KI08/09, të 14 nëntorit 2012, i qasshëm përmes vegëzës: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_08_09_vmsp_shq.pdf; dhe Njoftimin e Kryeprokurorit të Shtetit të për Mospërmbarim të Aktgjykimit në rastin KI08/09, të 28 majit 2019, i qasshëm përmes vegëzës: KI08-09_Njoftim-për-moszbatim-të-Aktgjykimit-të-Gjykatës-Kushtetuese_P.SH_.pdf (gjk-ks.org)

njoftuar Prokurorin e Shtetit për moszbatimin e këtij Aktgjykimi;[4] dhe (iv) në rastin KI187/13, të 1 prillit 2014, me parashtruese *N. Jovanović* (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI187/13), duke nxjerrë "Informatë të Përditësuar" përkitazi me Aktgjykimin KI187/13 si dhe duke e njoftuar Prokurorin e Shtetit për moszbatimin e Aktgjykimit KI187/13.[5]

Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI56/09:

8. Në rastin e Gjykatës KI56/09, kërkesa ishte dorëzuar nga *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë* (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

9. Parashtruesit e kërkesës kishin kontestuar Vendimin [01/011-3257] e 30 prillit 2009 të Kuvendit Komunal të Prizrenit për ndryshimin e Planit Urban për lagjen Jaglenica (tani Dardania) (në tekstin e mëtejmë: Vendimi për Planin Urban).

10. Parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të lartpërmendur, duke pretenduar shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenet 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]; 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor] dhe 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kishin kërkuar vendosjen e masës së përkohshme për pezullimin e Vendimit për Planin Urban, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

11. Më 25 nëntor 2009, Gjykata kishte miratuar masën e përkohshme *"për një kohë jo më të gjatë se tre (3) muaj nga dita e dhënies së [...]*

---

4 Shih shkresën *"Njoftimi përkitazi me moszbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI112/12"* dhe shkresën drejtuar Kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë, të 17 prillit 2014, të qasshme përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/08/KI112-12_Njoftim-perkitazi-me-moszbatimin-e-Aktgjykimit_P.SH_SHQ.pdf

5 Shih "*Informatë e Përditësuar përkitazi me Aktgjykimin nr.KI187-13*", të 6 shkurtit 2015, e qasshme përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/08/informate_e_perditesuar_KI187_13_shq.pdf dhe shkresën *"Informim për moszbatimin e Aktgjykimit KI187/13"*, të 6 shkurtit 2015 drejtuar Kryeprokurorin e Shtetit, e qasshme përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/08/njoftimi_për_moszbatimin_e_aktgjykimit_KI187_13_shq.pdf .

Vendimit".[6] Ndërsa, më 15 mars 2010, Gjykata kishte miratuar vazhdimin e masës së përkohshme për 45 ditë nga data 15 mars 2010.[7] Për më tepër, më 30 prill 2010, Gjykata sërish kishte miratuar vazhdimin e masës së përkohshme për dy (2) muaj nga data 30 prill 2010.[8]

12. Më 22 shtator 2010, Gjykata vendosi që: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë shkelje të së drejtës së parashtruesve të kërkesës të garantuar me nenin 52 (2) të Kushtetutës. Në këtë konstatim Gjykata erdhi pasi gjeti se Vendimi përkatës për Planin Urban ishte miratuar pa diskutim publik apo ndonjë lloj tjetër të pjesëmarrjes publike. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës nuk kishin pasur rast të dëgjohen nga institucioni publik lidhur me një çështje që kishte ndikim në mjedisin në të cilin jetojnë në kundërshtim me garancitë e paragrafit 2 të nenit 52 të Kushtetutës. Gjykata gjithashtu kërkoi nga Kuvendi Komunal i Prizrenit që t'i dorëzojë Gjykatës, brenda gjashtë (6) muajve, informata për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit në fjalë.

13. Dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI56/09, ishte votuar si në vijim:

Në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit, dhe Nenin 54 dhe 55 të Rregullores së punës, GJYKATA

VENDOS

I. Me shumicë votash që kërkesa është e pranueshme.

II. Njëzëri konstaton që ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesve të kërkesës të garantuar me Nenin 52 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

III. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

---

6 Shih Vendimin e Gjykatës lidhur me Kërkesën për masën e përkohshme në rastin KI56/09, të 25 nëntorit 2009.

7 Shih Vendimin e Gjykatës lidhur me vazhdimin e masës së përkohshme në rastin KI56/09, të 15 marsit 2010.

8 Shih Vendimin e Gjykatës lidhur me vazhdimin e masës së përkohshme në rastin KI56/09, të 30 prill 2010.

IV. KONSIDERON që Kuvendi Komunal [i] Prizrenit duhet t'i dorëzojë Gjykatës, brenda gjashtë muajve, informata për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe mund t'i bëhet rishikim editorial."

14. Më 24 janar 2011, Gjykata kishte njoftuar palët përkatëse për nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës KI56/09, si në vijim: (i) parashtruesin e kërkesës z. Fadil Hoxha; dhe (ii) Kuvendin Komunal të Prizrenit.

Procedura në Gjykatë pas publikimit të Aktgjykimit

15. Siç u tha më lart, Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI59/09, është votuar më 22 shtator 2010 dhe është publikuar më 22 dhjetor 2010.

16. Pas më tepër se një (1) viti nga nxjerrja e Aktgjykimit të Gjykatës, përkatësisht më 20 korrik 2012, parashtruesi i kërkesës KI56/09, Fadil Hoxha, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë që bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, të ndërmerren veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Aktgjykimi, pasi konsideronte se Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës nuk ishte zbatuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit. Ndërsa, më 19 nëntor 2012, Komuna e Prizrenit e kishte njoftuar Gjykatën se janë ndërprerë punimet në objektin në lagjen "Dardania" që ndërlidhen me Planit Urban të ndryshuar përmes Vendimit [Nr.01/011-3257] të 30 prillit 2009, të Kuvendit Komunal të Prizrenit.

17. Më 19 shkurt 2015, Gjykata i është drejtuar për informatë rreth zbatimit të Aktgjykimit KI56/09, Kryesuesit të Kuvendit Komunal dhe në përgjigjen përkatëse të pranuar nga Gjykata më 4 mars 2015, është theksuar më sa vijon: *"Kuvendi i Komunës, është i përkushtuar që në bazë të kompetencave që i jep Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, në njërën prej seancave të Kuvendit të Komunës do t'a debatoj dhe do të vendosë që, këtë çështje, ta harmonizoj sipas kërkesave të banorëve të asaj lagje dhe kërkesave të Gjykatës Kushtetuese, si dhe për veprimet që do ti ndërmarrë Kuvendi i Komunës së Prizrenit përkitazi me këtë çështje, do të i'u njoftojmë me kohë".*

18. Në ndërkohë, më 27 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës, sërish i drejtohet Gjykatës, duke theksuar, ndër tjerash, se Komuna e Prizrenit nuk ka organizuar asnjë diskutim publik me banorët e lagjes rreth kësaj çështjeje as pas nxjerrjes së Aktgjykimit KI56/09.

19. Më 7 shkurt 2020, Gjykata i është drejtuar sërish Kuvendit Komunal të Prizrenit me kërkesë për informatë përfundimtare lidhur me

zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KI56/09. Përmes kësaj shkrese, Gjykata e kishte paralajmëruar Kuvendin Komunal se bazuar në nenin 116 të Kushtetutës dhe rregullin 66 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së saj të punës, në mungesë të konfirmimit për zbatueshmërinë e plotë të Aktgjykimit përkatës brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditësh, Gjykata do të ndërmarrë masat e përcaktuara në Rregulloren e saj të punës, duke përfshirë Vendimin për Mospërmbarim dhe Njoftimin e Prokurorit të Shtetit. Gjykata, nuk kishte pranuar ndonjë informacion shtesë se a është zbatuar Aktgjykimi i Gjykatës apo jo.

20. Më 3 gusht 2021, Gjykata bazuar në rregullin 66 të Rregullores së Punës, rivlerësoi zbatueshmërinë e Aktgjykimeve të saj së bashku me shkresat përkatëse të pranuara dhe të dërguara nga Gjykata pas nxjerrjes së këtyre Aktgjykimeve, me qëllim të konstatimit nëse të njëjtat janë zbatuar. Bazuar në shkresat e dërguara nga Gjykata, rezultoi se nxjerrja e Aktvendimeve për Mospërmbarim është paralajmëruar në një numër rastesh, duke përshirë rastin KI56/09, përmes shkresës së Gjykatës drejtuar Kuvendit Komunal të Prizrenit, të 7 shkurtit 2020. Përkundër kësaj shkrese dhe në mënyrë që Gjykata të veprojë vetëm në bazë të informacionit të përditësuar, u vendos që shkresa përfundimtare duke kërkuar informata shtesë t'u dërgohen sërish palëve dhe autoriteteve përkatëse në një numër rastesh, duke përfshirë rastin e Gjykatës KI56/09.

21. Më 11 gusht 2021, me qëllim të përditësimit të informacionit përkitazi me zbatimin e Aktgjykimit përkatës, Gjykata i dërgoi shkresë: (i) parashtruesit të kërkesës, Fadil Hoxha; dhe (ii) Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Prizrenit, duke kërkuar sërish që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të njoftohet përfundimisht Gjykata se a është zbatuar apo jo, në tërësi, Aktgjykimi i Gjykatës KI56/09.

22. Më 19 gusht 2021, Gjykata ishte njoftuar nga Posta e Kosovës se nuk ka qenë e mundur që të dorëzohet shkresa drejtuar Kryesuesit të Kuvendit Komunal, me arsyetimin se ky i fundit gjendej në pushim vjetor, ndërsa zyrtarët e tjerë në komunë refuzuan pranimin e shkresës.

23. Më 23 gusht 2021, Gjykata sërish i dërgoi shkresën e lartcekur Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Prizrenit.

24. Më 30 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës Fadil Hoxha dorëzoi përgjigjen e tij në Gjykatë, duke theksuar, ndër tjerash, se: (i) Aktgjykimi i Gjykatës KI56/09, *"nuk është zbatuar, dhe për zbatimin e të njëjtin nuk është marrë asnjë veprim nga Kuvendi Komunal i*

Prizrenit ose Kryetari i Komunës së Prizrenit"; *(ii) "gjatë katër viteve të fundit i jemi drejtuar Kryetarit të Komunës së Prizrenit dy herë nëpërmjet shkresave zyrtare duke kërkuar të ndajë mjetet e nevojshme financiare për rrënimin e objektit kontestues, të rrënojnë atë si dhe të rikthejë plotësisht dedikimin e hapësirës përkatëse nëpërmjet rregullimit të parkut të lagjes, me pjesëmarrjen e banorëve, ekspertëve dhe organizatave të shoqërisë civile*"; dhe (iii) *" jo vetëm që nuk është rrënuar objekti, por i njëjti është shndërruar në deponi mbeturinash dhe pikë-takimi për grupe të ndryshme të individëve që përdorin substanca narkotikë, si dhe rezervar uji të kontaminuar [...]".*

25. Më 10 shtator 2021, Kryesuesi i Kuvendit Komunal dorëzoi përgjigjen e tij në Gjykatë, duke theksuar si në vijim: (i) "*lidhur me kërkesën dhe çështjet e parashtruara nga ana e juaj, unë deri më tani nuk kam qenë në njohuri*"; (ii) *"me seriozitetin më të madh dhe sipas rrethanave dhe mundësive të institucionit do të mundohemi ta trajtojmë [këtë çështje]";* dhe (iii) *"brenda mundësive ligjore në njërën nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, do të mundohemi t'i japim zgjidhje çështjeve të ngritura nga ana e juaj dhe banorëve të asaj lagjeje."*

Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI56/09:

26. Siç është sqaruar më lart, përmes shkresës drejtuar Kuvendit Komunal të Prizrenit, të 7 shkurtit 2020, duke u bazuar në nenin 116 të Kushtetutës dhe rregullit 66 të Rregullores së punës, Gjykata kishte paralajmëruar nxjerrjen e Vendimit për Mospërmbarim dhe njoftimin e Prokurorit të Shtetit në rastin KI56/09, në "*mungesë të konfirmimit për zbatueshmërinë e plotë të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI56/09*". Megjithatë, në gusht të vitit 2021, Gjykata edhe një herë i është drejtuar palëve përkatëse në mënyrë që të përditësohen informatat para Gjykatës, përkitazi me zbatueshmërinë e Aktgjykimit të saj.

27. Më 22 shtator 2021, bazuar në shkresat e dorëzuara në Gjykatë, siç janë paraqitur më lart, Gjykata njëzëri konstatoi se Aktgjykimi i saj në rastin KI56/09, nuk është zbatuar. Kjo, sepse autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tij, as pas më tepër se (10) vitesh nga nxjerrja e këtij Aktgjykimi, edhe pse kishin pezulluar punimet në objektin kontestues, nuk kanë ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin e plotë të tij, përkundër faktit që përmes Aktgjykimit përkatës, Gjykata kishte konstatuar se Vendimi [Nr.01/011-3257] i 30 prillit 2009 i Kuvendit Komunal të Prizrenit ishte miratuar pa diskutim publik apo ndonjë lloj

tjetër të pjesëmarrjes publike dhe rrjedhimisht parashtruesit e kërkesës nuk kishin pasur rast të dëgjohen nga institucioni publik lidhur me një çështje që kishte ndikim në mjedisin në të cilin jetojnë në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 52 të Kushtetutës, duke kërkuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit që t'i dorëzojë Gjykatës, brenda gjashtë (6) muajve, informata për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit në fjalë.[9]

28. Konstatimi i lartcekur bazohet në përgjigjen e palëve të dorëzuara në Gjykatë, përkatësisht: (i) parashtruesit të kërkesës, i cili ka theksuar, ndër tjerash, se as pas dhjetë (10) vjetësh, Komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës; dhe (ii) Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Prizrenit, i cili, ndër tjerash, ka theksuar se *"deri më tani nuk ka pasur njohuri lidhur me këtë rast*", por se "*në njërën nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, do të mundohen t'i japin zgjidhje çështjes së ngritur nga Gjykata, respektivisht, zbatimit të Aktgjykimit KI56/09*". Gjykata rrjedhimisht vëren se moszbatimi i Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI56/09, nuk është kontestuar as nga palët e përfshira në këtë rast.

29. Gjykata në mënyrë të njëjtë ka vepruar edhe në raste të tjera dhe të cituara më lart, në të cilat ka vlerësuar se në kundërshtim më nenin 116 të Kushtetutës, vendimet e saj nuk janë zbatuar. Në shkresën drejtuar u.d. të Kryeprokurorit të Shtetit të 6 shkurtit 2015 përkitazi me rastin e Gjykatës KI187/13, Gjykata, ndër tjerash, kishte theksuar se përkundër faktit që qysh nga themelimi i Gjykatës "*pothuajse 99% të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese janë zbatuar*", Gjykata "*duke qenë e përkushtuar që të ndjek procedurat e zbatimit të vendimeve të saj deri në realizimin e plotë të të drejtave të parashtruesve që dalin nga vendimet e saj*", identifikon rastet të cilat ende nuk kanë gjetur zbatim nga autoritetet përkatëse, duke u tërhequr vëmendjen *"institucioneve shtetërore që, në sajë të kompetencave dhe të detyrimeve kushtetuese që kanë, të sigurojnë mekanizma për ti zbatuar vendimet e saj, në përputhje të plotë me nenin 116.1 të Kushtetutës*". Ndërsa, në shkresën e drejtuar Kryeprokurorit të Shtetit të 28 majit 2019, përkitazi me rastin e Gjykatës KI08/09 dhe njoftimin përkatës për nxjerrjen e Vendimit për Mospërmbarim, ndër tjerash, Gjykata kishte theksuar se "*mosekzekutimi i vendimeve të Gjykatës*

[9] Një konstatim të ngjashëm Gjykata e kishte nxjerrë në Vendimin për Mospërmbarim të rastit KO08/09, të cekur më lart, ku në paragrafin 23 kishte theksuar se *"Gjykata Kushtetuese tani gjen se afati që i është dhënë autoriteteve zbatuese për përmbarimin e Aktgjykimit të saj, në rastin KI08/09, ka skaduar pothuajse qe dy vjet"*.

Kushtetuese përbën shkelje kushtetuese dhe është në kundërshtim me parimet bazë të sundimit të ligjit në një shtet ligjor dhe demokratik".

30. Gjykata gjithashtu thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDJ), bazuar në të cilën, Gjykata sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, interpreton të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, thekson se një ndër aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili, ndër tjerash, kërkon që vendimet përfundimtare të gjykatave duhet të zbatohen dhe të mos vihen në pikëpyetje.[10] Për më tepër, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, në mënyrë konsistente përcakton që e drejta për një proces të rregullt siç garantohet përmes nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe e cila është në mënyrë të drejtpërdrejtë e aplikueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës bazuar në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës së saj, do të ishte "*iluzore*" nëse sistemet ligjore vendore do të "*lejonin një vendim gjyqësore të përfundimtarë të mbetej i pazbatuar në dëm të një pale*" dhe do të ishte e "*paimagjinueshme që nenin 6 të përshkruaj në detaje garancitë procedurale të palëve – procedura të drejta, publike dhe të shpejta – pa i dhënë mbrojtje zbatimit të vendimeve gjyqësore*".[11] Situata të tilla do të ishin në kundërshtim të hapur me parimin e sundimit të ligjit të cilin shtetet kontraktuese e kanë marrë për detyrë ta respektojnë bazuar në KEDNJ-në.

31. Gjykata, për më tepër, rikujton që Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 3 [Barazia para Ligjit] të saj përcakton që Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Për më tepër, Kushtetuta në nenin 7 [Vlerat], gjithashtu përcakton që rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës,

---

[10] Shih, ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *G*uðmundur *Andri* Ástráðsson *v. Island,* kërkesa nr.23674/18*,* Aktgjykim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së i 1 dhjetorit 2020, paragrafi 238; *Brumărescu v. Rumani*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së i 28 tetorit 1999, paragrafi 61; si dhe *Agrokompleks v. Ukraine*, kërkesa nr. 23465/03, Aktgjykim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së i 25 korrik 2013, paragrafi 148.

[11] Shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së *Romashov v. Ukrain*e, kërkesa nr.67534/01, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 24 korrikut 2004, paragrafi 42.

mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut. Sundimi i ligjit është po ashtu element që e reflekton trashëgiminë e përbashkët evropiane siç është përcaktuar në preambulën e KEDNJ-së të Këshillit të Evropës dhe Kartës për të Drejtat Themelore të Bashkimit Evropian, dhe objektivë thelbësore e reflektuar në Statutin e Komisionit të Venecias.[12]

32. Marrë parasysh parimet e lartcekura, dhe pasi bazuar në shkresat e dorëzuara para saj, Gjykata ka konstatuar se Aktgjykimi në rastin KI56/09, nuk është zbatuar nga autoritet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 116 të Kushtetutës dhe rregullin 66 të Rregullores së punës, Gjykata nxjerr këtë Aktvendim për Mospërmbarim përkitazi me rastin e Gjykatës KI56/09. Në të njëjtën kohë, Gjykata gjithashtu e njofton Prokurorin e Shtetit përkitazi me moszbatimin e Aktgjykimit të saj në rastin KI56/09.

33. Në fund, duhet të theksohet se përtej konstatimit të moszbatimit të një Aktgjykimi, përmes Vendimit për Mospërmbarim dhe Njoftimit përkatës të Prokurorit të Shtetit, Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë për vlerësimin e përgjegjësisë për moszbatim të një vendimi të Gjykatës nga autoriteteve përgjegjëse. Kompetenca për një vlerësim të tillë më pas i takon Prokurorit të Shtetit, bazuar në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 19 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe me rregullin 66 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 22 shtator 2021, njëzëri:

VENDOSI

I. TË KONSTATOJË që Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KI56/09, me parashtrues *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë*, i 22 shtatorit 2010 **nuk është zbatuar** nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Kosovës;

---

[12] Shih, ndër tjerash, (i) Preambulën e KEDNJ-së; (ii) Preambulën e Kartës për të Drejtat Themelore të Bashkimit Evropian; si dhe (iii) Statutin e Komisionit të Venecias.

II. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim për Mospërmbarim përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KI56/09;

III. T'UA KOMUNIKOJË palëve këtë Aktvendim për Mospërmbarim;

IV. TË NJOFTOJË Prokurorin e Shtetit për nxjerrjen e këtij Aktvendimi për Mospërmbarim;

V. Në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe për qëllime të rregullit 66 (6) të Rregullores së punës, ky vendim do të publikohet në Gazetë Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në ueb-faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

AKTVENDIM PËR MOSPËRMBARIM

lidhur me

AKTGJYKIMIN

e

Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

të 19 majit 2016

në

rastin nr. KI132/15

parashtrues

Manastiri i Deçanit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së dy Vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Objekti i çështjes:

1. Bazuar në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 19 (Marrja e vendimeve) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 66 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës nr. 01/2018 të Gjykatës Kushtetuese të

Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës), objekti i çështjes është: (i) vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), përkitazi me zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI132/15, me parashtrues *Manastiri i Deçanit*, Aktgjykim i 19 majit 2016 (në tekstin e mëtejmë: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI132/15), nga ana e autoriteteve përgjegjëse të Republikës së Kosovës; dhe (ii) vendimmarrja e Gjykatës përkitazi me Aktvendimin për Mospërmbarim dhe Njoftimi përkatës për Prokurorin e Shtetit, siç është përcaktuar në paragrafët (6) dhe (7) të Rregullit 66 të Rregullores së punës.

Baza juridike për nxjerrjen e Aktvendimit për Mospërmbarim dhe Njoftimin e Prokurorit të Shtetit:

2. Gjykata fillimisht do të citojë, e më pas elaborojë, bazën juridike për nxjerrjen e këtij Aktvendimi për Mospërmbarim dhe lëshimin e Njoftimit për Prokurorin e Shtetit përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI132/15. Në vijim, dispozitat relevante të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 116
[Efekti Juridik i Vendimeve]

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.
[...]

Ligji për Gjykatën Kushtetuese

Neni 19
(Marrja e Vendimeve)

4. Gjykata Kushtetuese vendos si trup gjykues i përbërë prej të gjithë gjyqtarëve të pranishëm të Gjykatës Kushtetuese.
5. Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë (7) gjyqtarë.
6. Gjykata Kushtetuese merr vendime me shumicën e votave të gjyqtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.
[...]

Rregullorja e punës

Rregulli 66
(Zbatimi i vendimeve)

(1) Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe për institucionet e Republikës së Kosovës.
(2) Të gjitha organet kushtetuese, si dhe gjykatat e autoritetet, janë të obliguara të respektojnë, të jenë në përputhje dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës, brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.
(3) Të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të respektojnë vendimet e Gjykatës dhe t'u përmbahen atyre.
(4) Gjykata mund të specifikojë, në vendimin e saj, mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e vendimit të Gjykatës.
(5) Organi i obliguar për të zbatuar vendimin e Gjykatës do të dorëzojë informatat, nëse kërkohet dhe ashtu siç kërkohet me vendim, për masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit të Gjykatës.
(6) Në rast të moszbatimit të një vendimi, ose të vonesës në dhënien e informacioneve për Gjykatën për masat e ndërmarra, Gjykata mund të lëshojë një aktvendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar. Ky aktvendim publikohet në Gazetën Zyrtare.
(7) Prokurori i Shtetit informohet për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar.
(8) Sekretariati, nën mbikëqyrjen e gjyqtarit, i cili në pajtim me rregullin 58 e ka hartuar vendimin, do ta përcjellë zbatimin e vendimit, si dhe, sipas nevojës, do t'i raportojë Gjykatës me rekomandimin për procedurat e mëtejmë ligjore që duhet të ndërmerren.

3. Baza e lartcekur ligjore paraqet rregullimin kushtetues dhe ligjor bazuar mbi të cilin Gjykata është e autorizuar të ndërmarrë veprime përkitazi me monitorimin e zbatimit të Aktgjykimeve të saj dhe masat përkatëse në rast të konstatimit të moszbatimit të tyre.

4. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, vendimet e saj janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Për më tepër, bazuar në të njëjtin në lidhje me rregullin 66 të Rregullores së punës: (i) të gjitha organet kushtetuese, si dhe gjykatat e autoritetet, janë të obliguara të respektojnë, të jenë në përputhje dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës, brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj; dhe (ii) të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të respektojnë vendimet e Gjykatës dhe t'u përmbahen atyre.

5. Gjykata gjithashtu thekson se bazuar në rregullin 66 të Rregullores së punës, Gjykata mund të specifikojë në vendimin e saj: (i) mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e vendimit të Gjykatës; (ii) organet e obliguara për të zbatuar vendimin e Gjykatës dhe të dorëzojnë informatat, nëse kërkohet dhe ashtu siç kërkohet me vendim, për masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit të Gjykatës; (iii) në rast të moszbatimit të një vendimi, ose të vonesës në dhënien e informacioneve për Gjykatën për masat e ndërmarra, Gjykata mund të lëshojë një Aktvendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar dhe të publikojë këtë qëndrim në Gazetën Zyrtare; dhe (iv) të informojë Prokurorin e Shtetit për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar.

6. Bazuar në paragrafin (8) të Rregullit 66 të Rregullores së punës, Gjykata përmes mekanizmave të saj përcjellë zbatimin e vendimeve dhe mund të ndërmarrë procedura të mëtejmë ligjore. Vlerësimi i zbatimit të vendimeve të Gjykatës bëhet në mënyrë periodike dhe në rast të konstatimit se një vendim nuk është zbatuar, Gjykata nxjerr Aktvendim për Mospërmbarim dhe njofton Prokurorin e Shtetit.

7. Në këtë kontekst, Gjykata ka ndërmarrë masat e përcaktuara në Rregulloren e saj të punës përkitazi me Aktgjykimet: (i) në rastin KO01/09, të 18 marsit 2010, me parashtrues *Qemail Kurtishi* (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KO01/09), duke lëshuar Urdhrin e 7 qershorit 2010 dhe Urdhrin e 21 qershorit 2010[13]; (ii) në rastin KI08/09, të 17 dhjetorit 2010, me parashtrues *Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK,* në Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI08/09), duke nxjerrë Vendim për Mospërmbarim dhe e kishte njoftuar Prokurorin e Shtetit[14]; (iii) në rastin KI112/12, të 5 korrikut 2013, me parashtrues *Adem Meta* (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI112/12), duke iu drejtuar me shkresë Kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe duke e

---

[13] Shih Urdhrin në rastin KO01/09, të 7 qershorit 2010, i qasshëm përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/urdher_rasti_ko_01_09.pdf dhe Urdhrin në rastin KO01/09, të 21 qershorit 2010, i qasshëm përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/urdher_rasti_ko_01_09.pdf

[14] Shih Vendimin për Mospërmbarim të Aktgjykimit në rastin KI08/09, të 14 nëntorit 2012, i qasshëm përmes vegëzës: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_08_09_vmsp_shq.pdf; dhe Njoftimin e Kryeprokurorit të Shtetit të për Mospërmbarim të Aktgjykimit në rastin KI08/09, të 28 majit 2019, i qasshëm përmes vegëzës: KI08-09_Njoftim-për-moszbatim-të-Aktgjykimit-të-Gjykatës-Kushtetuese_P.SH_.pdf (gjk-ks.org).

njoftuar Prokurorin e Shtetit për moszbatimin e këtij Aktgjykimi;[15] dhe (iv) në rastin KI187/13, të 1 prillit 2014, me parashtruese *N. Jovanović* (në tekstin e mëtejmë: rasti i Gjykatës KI187/13), duke nxjerrë "Informatë të Përditësuar" përkitazi me Aktgjykimin KI187/13 si dhe duke e njoftuar Prokurorin e Shtetit për moszbatimin e Aktgjykimit KI187/13.[16]

Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI132/15:

8. Në rastin e Gjykatës KI132/15, kërkesa ishte dorëzuar nga Manastiri i Deçanit, i cili përfaqësohej në procedurat para Gjykatës Kushtetuese nga Dragutin (Sava) Janjić, kryemurg i Manastirit të Deçanit.

9. Parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar dy vendime të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (ne tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave të DHPGJS-së), përkatësisht Vendimet [AC-I-13-0008] dhe [AC-I-13-0009] të 12 qershorit 2015.

10. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të lartpërmendura, duke pretenduar shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia Para Ligjit]; 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; 46 [Mbrojtja e Pronës]; 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ). Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte kërkuar vendosjen e masës së përkohshme deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

---

[15] Shih shkresën *"Njoftimi përkitazi me moszbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI112/12"* dhe shkresën drejtuar Kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë, të 17 prillit 2014, të qasshme përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/08/KI112-12_Njoftim-perkitazi-me-moszbatimin-e-Aktgjykimit_P.SH_SHQ.pdf

[16] Shih "*Informatë e Përditësuar përkitazi me Aktgjykimin nr.KI187-13*", të 6 shkurtit 2015, e qasshme përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/08/informate_e_perditesuar_KI187_13_shq.pdf dhe shkresën *"Informim për moszbatimin e Aktgjykimit KI187/13"*, të 6 shkurtit 2015 drejtuar Kryeprokurorin e Shtetit, e qasshme përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/08/njoftimi_për_moszbatimin_e_aktgjykimit_KI187_13_shq.pdf.

11. Më 12 nëntor 2015, Gjykata kishte miratuar masën e përkohshme deri më 29 shkurt 2016.[17] Ndërsa, më 10 shkurt 2016, Gjykata kishte miratuar vazhdimin e masës së përkohshme deri më 31 maj 2016.[18]

12. Më 19 maj 2016, Gjykata vendosi që: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë që ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) të konstatojë që dy Vendimet e 12 qershorit 2015 të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, përkatësisht [nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009], janë të pavlefshme; dhe (iv) të konstatojë që dy Vendimet e Kolegjit të Specializuar për Pronësinë të DHPGJS-së të 27 dhjetorit 2012, përkatësisht [nr. SCC-08-0026 dhe nr. SCC-08-0227], janë përfundimtare, të detyrueshme dhe, si të tilla, janë *res judicata*.[19]

13. Dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI132/15, ishte votuar si në vijim:

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në mbështetje të neni 20 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 19 maj 2016, me shumicë votash

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË që ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË KONSTATOJË që nuk është e nevojshme të ekzaminojë nëse ka pasur shkelje të neneve 24, 32, 46 dhe 54 të Kushtetutës, dhe të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

---

17 Shih Vendimin e parë të Gjykatës për miratim të masës së përkohshme në rastin KI132/15.

18 Shih Vendimin e dytë të Gjykatës për vazhdim të masës së përkohshme në rastin KI132/15.

19 Më gjerësisht lidhur me faktet e rastit, shih paragrafët 20-46 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI132/15; lidhur me pretendimet, shih paragrafët 47-52; lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, shih paragrafët 53-68; ndërsa, lidhur me arsyetimin dhe meritat e rastit, shih paragrafët 69-94.

IV. TË KONSTATOJË që dy vendimet e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, janë të pavlefshme, dhe se dy vendimet e Kolegjit të Specializuar për Pronësinë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 27 dhjetorit 2012, nr. SCC-08-0026 dhe nr. SCC-08-0227, janë përfundimtare të detyrueshme dhe, si të tilla, janë res judicata;

V. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VI. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë."

14. Më 20 maj 2016, Gjykata kishte njoftuar palët përkatëse për nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës, si në vijim: (i) DHPGJS-në; (ii) Degën në Deçan të Gjykatës Themelore në Pejë; (iii) Komunën e Deçanit; (iv) NSH Bletaria "Apiko" (në tekstin e mëtejmë: Apiko); dhe (v) NSH Ndërmarrjen Hoteliere Turistike "Iliria" (në tekstin e mëtejmë: "Iliria").

Procedura në Gjykatë pas publikimit të Aktgjykimit:

15. Siç u tha më lart, Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI132/15, është votuar më 19 maj 2016 dhe është publikuar më 20 maj 2016.

16. Dy (2) vite pas nxjerrjes së Aktgjykimit të Gjykatës, përkatësisht më 8 mars 2018, Manastiri i Deçanit dorëzoi një letër-kërkesë në Gjykatë lidhur me zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI132/15, duke theksuar se i njëjti nuk është zbatuar "*për shkak të refuzimit të komunës së Deçanit që këtë vendim ta zbatojë*". Përmes shkresës në fjalë, Manastiri i Deçanit e njoftoi Gjykatën se: (i) më 23 prill 2017, kishte kërkuar zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI132/15 nga Zyra Kadastrale e Komunës së Deçanit; (ii) më 26 maj 2017, Zyra e Kryetarit të Komunës së Deçanit, kishte refuzuar kërkesën e Manastirit të Deçanit; (iii) më 3 korrik 2017, kishte parashtruar ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: AKK); (iv) më 25 korrik 2017, AKK kishte kërkuar dokumentacion shtesë nga Manastiri i Deçanit; dhe (v) më 2 gusht 2017, Manastiri i Deçanit kishte dorëzuar dokumentet e kërkuara në AKK. Bazuar në shkresën e Manastirit të

Deçanit, AKK nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim, dhe për pasojë, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Gjykata që të veprojë bazuar në nenin 116 të Kushtetutës lidhur me zbatimin e Aktgjykimit të saj në rastin KI132/15.

17. Bazuar në shkresat e dorëzuara në Gjykatë, përgjigja e Zyrës së Komunës së Deçanit e 26 majit 2017, drejtuar Manastirit të Deçanit, ndër tjerash, thekson se (i) "*me rastin marrjes së vendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kuvendi Komunal i Deçanit ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme dhe ka marrë vendime në të cilat e kundërshton zbatimin e këtyre vendimeve dhe decidivisht është thënë se Drejtoria për Kadastër në Deçan dhe Agjencia Kosovare e Gjeodezisë të mos i zbatojë vendimet e lartpërmendura*"; (ii) "*menjëherë pas marrjes së vendimit të lartpërmendur gjyqësor të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Ndërmarrjet Publike "Iliria" dhe "Apiko" me padi pranë Gjykatës Themelore në Pejë – Dega Deçan, kanë kërkuar anulimin e të gjitha kontratave për dhurim të tokave për Manastirin. Prej asaj kohe e deri në ditën e sotme Gjykata nuk i ka shqyrtuar këto padi*"; (iii) "*AKP* [Agjencia Kosovare e Privatizimit] *me padi ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës anulimin e të gjitha kontratave të lartpërmendura mbi dhuratat dhe gjithashtu prej atëherë e deri në ditën e sotme padia nuk është marrë në shqyrtim*"; (iv) "*në lidhje me këto ngastra kemi gjetur edhe Aktvendimin e Drejtorisë Komunale të Gjeodezisë në Deçan me numrin 07-952/624 të dt. 15.09.1992 me të cilin këto ngastra i kthehen në pronësi Komunës së Deçanit nga OP "Visoki Deçani". Komuna e ka nisur zbatimin e këtij vendimi*"; (v) "*me ligj është paraparë se pronat e Ndërmarrjeve Publike për të cilat është nisur procedura e likuidimit nuk guxojnë ta ndryshojnë pronarin derisa nuk përfundon likuidimi. Kështu që për Ndërmarrjet Publike "Iliria" dhe "Apiko" ka filluar likuidimi më 22.02.2017*"; dhe përfundimisht (vi) "*duke marrë parasysh këto rrethana të lartpërmendura, ne si komunë nuk kemi mundësi të marrim çfarëdo vendimi*".

18. Më 8 nëntor 2018, Gjykata i ishte drejtuar DHPGJS-së lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës që Aktgjykimi i Gjykatës nuk është zbatuar dhe masat e ndërmarra nga DHPGJS-së për zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI132/15. Përmes kësaj shkrese, Gjykata kishte kërkuar që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të njoftohet nëse Aktgjykimi përkatës ishte zbatuar në tërësinë e tij. Për më tepër, shkresa e Gjykatës gjithashtu kishte theksuar se (i) "*nuk ka asnjë arsye në bazë të të cilës mund të arsyetohet mos-zbatueshmëria e një vendimi final dhe përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese*"; (ii) "*është*

përgjegjësi e organeve përgjegjëse që të gjejnë mënyrat dhe mjetet më të përshtatshme për të zbatuar një vendim të Gjykatës Kushtetuese në të cilin është gjetur se ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut"; (iii) "*në mungesë të konfirmimit për zbatueshmërinë e plotë të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI132/15, Gjykata Kushtetuese do të nxjerrë Vendim për Mospërmbarim, në përputhje me pikën (6) të rregullit 66 (Zbatimi i Vendimeve) të Rregullores së punës sipas të cilës parashihet që në rast të moszbatimit të një vendimi ose vonesës në dhënien e informacioneve, Gjykata Kushtetuese mund të lëshojë një aktvendim në të cilin do të theksohet që një vendim nuk është zbatuar. Më pas, në përputhje me pikën (7) të po të njëjtit rregull: Prokurori i Shtetit [do të] informohet për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar*". Përfundimisht, Gjykata kishte theksuar se bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, vendimet e shpallura nga Gjykata Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës dhe se *"mosekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përbën shkelje kushtetuese dhe është në kundërshtim me parimet bazë të sundimit të ligjit në një shtet ligjor dhe demokratik*".

19. Më 28 janar 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës, përkatësisht, Manastirin e Deçanit, se: (i) Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI132/15 është shpallur nga Gjykata më 20 maj 2016; (ii) i njëjti është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës; (iii) më 20 maj 2016, lidhur me Aktgjykimin përkatës ishte njoftuar "*Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Gjykata Themelore në Pejë-Dega Deçan, Komuna e Deçanit dhe ndërmarrjet "Apiko" dhe "Iliria"*"; (iv) bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, Aktgjykimi në rastin KI132/15 krijon detyrime për të gjitha palët e përfshira në proces; (v) Gjykata në vazhdimësi përcjell zbatimin e vendimeve të veta; dhe (vi) lidhur me Aktgjykimin në rastin KI132/15 dhe të gjitha vendimet e tjera të saj do të "*ndërmarrë të gjitha veprimet që ka në dispozicion në bazë të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së vet të punës*".

20. Më 21 nëntor 2019, DHPGJS-së dorëzoi në Gjykatë përgjigjen ndaj shkresës së Gjykatës për "*informatë përfundimtare lidhur me zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI132/15*" të 8 nëntorit 2018. Përmes kësaj shkrese, DHPGJS-së, ndër tjerash, theksoi se: (i) "*Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, konsideron njësoj ashtu siç keni konstatuar edhe Ju në kërkesën tuaj se dy Aktgjykimet e Dhomës së Posaçme, SCC-08-0226 dhe SCC-08-0227 janë përfundimtare të detyrueshme dhe të përshtatshme për përmbarim*"; (ii) "*në bazë të*

nenit 116.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës"; porse (iii) DHPGJS "*nuk ka asnjë autorizim ligjor të dhënë me Ligj që ka të bëjë me përmbarimin e Aktgjykimit përfundimtarë të gjykatave*"; dhe (iv) për më tepër, "*Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin KI132/15 nuk ka dhënë asnjë detyrë për Dhomën e Posaçme që duhet kryer në të ardhmen*". Duke vënë theks në juridiksionin e përcaktuar me ligj dhe faktin se DHPGJS "*nuk ka autoritet ligjor dhe nuk mund të ndërmarrë asnjë veprim ligjor në zbatimin e këtij Aktgjykimi*", DHPGJS megjithatë kishte theksuar se: (i) "*Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme informon se Aktgjykimet e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të cilat janë shpallë si përfundimtare dhe të detyrueshme me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI132/15 dhe në mungesë të kërkesës së palës, ende nuk janë pajisur me Klauzolën e plotfuqishmërisë, për të qenë të përshtatshme për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese*"; dhe (ii) "*deri më tani parashtruesi i kërkesës, Manastiri i Deçanit si palë në procedurë edhe pse ka interes ligjor e legjitim që të zbatohet Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, nuk ka parashtruar asnjë kërkesë në Dhomën e Posaçme, me të cilën kërkohet vendosja e klauzolës së plotfuqishmërisë në Aktgjykime e lëshuara, përfundimtare. DHPGJS-ja menjëherë do t'i pajisë këto Aktgjykime me klauzolën e plotfuqishmërisë*". Në fund, DHPGJS-së, gjithashtu kishte theksuar se (i) "*nisur nga siç u tha më lartë, Dhoma e Posaçme është e mendimit që në pajtim me nenin 307.1 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, pala gjyq fituese ka autorizim ligjor të fillon që të ndërmarrë hapat e nevojshme ligjor me qëllim të përmbarimit të këtyre Aktgjykimeve përfundimtare, duke ju drejtuar me kërkesë Gjykatës përmbarimore, apo Zyrës Kadastrale në Komunën në të cilën gjendet prona lëndore e Aktgjykimit, për regjistrimin e saj në regjistrin kadastral në emër të saj*"; dhe (ii) "*për më tepër në bazë të nenit 13.1 nr.04/L-013 të Ligjit për Kadastër, vetë pala që ka interes të këtillë për zbatimin e Aktgjykimit, duhet ta parashtroj kërkesën tek organi kadastral për fillimin e procedurës për regjistrimin e të drejtës pronësore ne regjistrin kadastral.*"

21. Më 3 gusht 2021, Gjykata bazuar në rregullin 66 të Rregullores së Punës, rivlerësoi zbatueshmërinë e Aktgjykimeve të saj së bashku me shkresat përkatëse të pranuara dhe të dërguara nga Gjykata pas nxjerrjes së këtyre Aktgjykimeve, me qëllim të konstatimit nëse të njëjtat janë zbatuar. Bazuar në shkresat e dërguara nga Gjykata, rezultoi se nxjerrja e Aktvendimeve për Mospërmbarim është paralajmëruar në një numër rastesh, duke përshirë rastin KI132/15, përmes shkresës së Gjykatës drejtuar DHPGJS të datës 21 nëntor

2019. Përkundër kësaj shkrese dhe në mënyrë që Gjykata të veprojë vetëm në bazë të informacionit të përditësuar, u vendos që shkresat përfundimtare duke kërkuar informata shtesë t'u dërgohen palëve dhe autoriteteve përkatëse në një numër rastesh, duke përfshirë, rastin e Gjykatës KI132/15.

22. Më 11 gusht 2021, me qëllim të përditësimit të informacionit përkitazi me zbatimin e Aktgjykimit përkatës, Gjykata i dërgoi shkresë (i) parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) AKK-së, duke marrë parasysh përmbajtjen e përgjigjes së DHPGJS-së dorëzuar në Gjykatë më 21 nëntor 2019 dhe faktin që, bazuar në shkresat e lëndës, ankesa e 3 korrikut 2017 e parashtruesit të kërkesës kundër vendimit të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Deçanit rezultonte të jetë në shqyrtim para saj.

23. Më 26 gusht 2021, AKK dorëzoi përgjigjen e saj në Gjykatë, duke theksuar, ndër tjerash, se (i) më 20 nëntor 2020, ka pranuar edhe ankesën [nr.03/3539/20] të parashtruar nga Manastiri i Deçanit; (ii) pas shqyrtimit të ankesës së lartcekur ka konstatuar se Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Deçanit, nuk ka vepruar në pajtim me paragrafin 3.5 të nenit 3 (Regjistrimi i të drejtave të pronave të paluajtshme) të Ligjit nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, sepse "*ka bërë heshtje administrative në shqyrtimin e kërkesës së parashtruar nga përfaqësuesi i Manastirit të Deçanit*"; (iii) për pasojë, AKK ka lëshuar Aktvendimin [nr. 03/3539/20] të 17 dhjetorit 2020, përmes të cilit e ka detyruar Drejtorinë e Kadastrit në Komunën e Deçanit që të bëjë shqyrtimin e ankesës së Manastirit të Deçanit; (iv) më 15 janar 2021, i është drejtuar Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Deçanit për kërkesë për informacion për veprimet e ndërmarra përkitazi me ankesën e lartcekur; (v) më 21 janar 2021, AKK është njoftuar nga Komuna përkatëse se ndaj Aktvendimit të lartcekur të 17 dhjetorit 2020 të AKK-së ka ushtruar padi në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë; (vi) më 18 shkurt 2021, Manastiri i Deçanit ka parashtruar ankesë në AKK për shkak të heshtjes administrative; (vii) më 22 mars 2021, AKK ka pranuar kërkesë nga Kryetari i Komunës së Deçanit, përmes së cilës është kërkuar që të mos procedohet kjo lëndë derisa të përfundojnë "*të gjitha negociatat që kanë filluar me Manastirin e Decanit, Qeverisë së Kosovës, Ambasadorët e Kuintit, OSBE dhe BE*" lidhur me çështjen në fjalë; (viii) pas shkresës së lartcekur të Kryetarit të Komunës, AKK nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim; dhe (ix) pas pranimit të shkresës së Gjykatës të 11 gushtit 2021, më 16 gusht 2021, AKK i është drejtuar Kryetarit të Komunës së Deçanit me kërkesë për informacion lidhur

me zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës KI132/15 dhe nuk ka pranuar përgjigje.

24. Më 30 gusht 2021, Manastiri i Deçanit dorëzoi përgjigjen e tij në Gjykatë, duke sqaruar zhvillimet që kanë ndodhur që nga korrespondenca e fundit me Gjykatën Kushtetuese, duke bashkangjitur edhe shkresat relevante nga të cilat rezulton se: (i) më 26 gusht 2020, Manastiri i Deçanit, sërish kishte paraqitur kërkesë për regjistrimin e pronësisë sipas Aktgjykimit KI132/15 në Zyrën e Kadastrit të Komunës së Deçanit; (ii) pasi nuk kishte pranuar përgjigje në këtë kërkesë, më 12 tetor 2020, Manastiri i Deçanit kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit në Zyrën e Kadastrit të Komunës së Deçanit; (iii) më 20 nëntor 2020, duke marrë parasysh që nuk kishte pranuar përgjigje nga zyra përkatëse në Komunën e Deçanit, Manastiri i Deçanit kishte parashtruar ankesë për shkak të heshtjes administrative në AKK; (iv) më 17 dhjetor 2020, AKK përmes Aktvendimit [03/3539/20], kishte kërkuar nga Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi në Deçan që të vendos lidhur me kërkesën e Manastirit të Deçanit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh; (v) Komuna e Deçanit nuk kishte nxjerrë vendimin sipas Aktvendimit të lartcekur të AKK-së, por më 21 janar 2021, kishte paraqitur padi kundër Aktvendimit të AKK-së në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të cilës Manastiri i Deçanit i është përgjigjur më 24 mars 2021; (vi) më 18 shkurt 2021, Manastiri i Deçanit, përsëri kishte paraqitur ankesë në AKK për shkak të heshtjes administrative nga ana e Komunës së Deçanit, duke theksuar, ndër tjerash, se bazuar në nenin 13 (Konflikti administrativ) të Ligjit nr.03/L-292 për Konfliktet Administrative, konflikti administrativ në këtë rast nuk është i lejuar, për më tepër që, bazuar në nenin 22 të të njëjtit ligj, padia nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit përkatës; dhe (vii) Manastiri i Deçanit nuk ka pranuar përgjigje nga AKK përkundër faktit që bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, "*është obligim i të gjitha organeve dhe personave në Kosovë që të zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese*". Manastiri i Deçanit po ashtu thekson se (i) "*Kuvendi Komunal i Deçanit ka mbajtur seancë më 27.05.2019 në të cilën përsëri është paraqitur qëndrimi që Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese është i padrejtë dhe të cilin Komuna nuk do ta zbatojë, si dhe që zbatimi i Aktgjykimit do të krijonte pengesa të mëdha në mesin e qytetarëve të Komunës së Deçanit, për pasojat e së cilës Komuna nuk do të mund të përgjigjej*"; (ii) "*është e qartë që institucionet në të gjitha nivelet thjeshtë refuzojnë të zbatojnë këtë vendim, domethënë kryejnë pengesë të vetëdijshme dhe të qëllimshme të të drejtave tona*"; dhe (iii) "*luteni që të ndërmerrni gjithçka që keni në dispozicion, në mënyrë që e drejta jonë mbi tokën, përfundimisht të regjistrohet në*

emrin tonë, pesë vite pasi që Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë Aktgjykimin numër KI132/15."

25. Më 3 shtator 2021, AKK dorëzoi në Gjykatë përgjigjen e Komunës së Deçanit lidhur me "*çështjen e Manastirit të Deçanit*" të datës 1 shtator 2021, përmes së cilës Kryetari i Komunës së Deçanit kishte theksuar, ndër tjerash, se (i) "*Komuna e Deçanit në vazhdimësi është shprehur dhe ka deklaruar mos pajtueshmërinë e saj me Aktgjykimin KI132/15 që ka të bëjë me pronat e Ndërmarrjeve Shoqërore APIKO dhe ILIRIA, të cilat me Aktgjykimin e lartë cekur [...] i janë dhënë (dhuruar) Manastirit të Deçanit*"; (ii) "*nga viti 2017, kemi tentuar që të kemi një mirëkuptim dhe një zgjidhje të harmonizuar me Manastirin e Deçanit për të përfunduar të gjitha kontestet me Manastirin e Deçanit*"; (iii) "*ju njoftojmë që Komuna e Deçanit nuk ka asnjë arsye e asnjë obligim dhe nuk merr përsipër zbatimin e këtij vendimi, përderisa të mos merr fund trajtimi përmes bisedimeve në mes Komunës dhe Manastirit ku do të zgjidheshin përfundimisht kontestet e krijuara mes nesh*"; dhe (iv) "*deri në një epilog përfundimtar kërkojmë nga AKK-ja që mos të merr asnjë veprim lidhur me këtë proces!.*"

Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI132/15:

26. Siç është sqaruar më lart, përmes shkresës drejtuar DHPGJS-së të 8 nëntorit 2019, duke u bazuar në nenin 116 të Kushtetutës dhe rregullin 66 të Rregullores së punës, Gjykata kishte paralajmëruar nxjerrjen e Vendimit për Mospërmbarim dhe njoftimin e Prokurorit të Shtetit përkitazi me rastin e Gjykatës KI132/15, në "*mungesë të konfirmimit për zbatueshmërinë e plotë të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI132/15*". Megjithatë, në gusht të vitit 2021, Gjykata edhe një herë i është drejtuar palëve përkatëse në mënyrë që të përditësohen informatat para Gjykatës përkitazi me zbatueshmërinë e Aktgjykimit të saj.

27. Më 22 shtator 2021, bazuar në vlerësimin e të gjitha shkresave para saj, siç janë paraqitur më lart, Gjykata njëzëri konstatoi se Aktgjykimi i saj në rastin KI132/15, nuk është zbatuar. Kjo sepse autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tij, as pas pesë (5) viteve të nxjerrës së këtij Aktgjykimi, nuk kanë ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin e tij, përkundër faktit që përmes Aktgjykimit të Gjykatës, dy Vendimet e Kolegjit të Specializuar për Pronësinë të 27 dhjetorit 2012 të DHPGJS-së [nr. SCC-08-0026] dhe [nr.SCC-08-0227], respektivisht, ishin

deklaruar si përfundimtare, të detyrueshme dhe, si të tilla, *res judicata*.

28. Në konstatimin e lartcekur Gjykata ka ardhur duke u bazuar në shkresat e pasqyruara në këtë Aktvendim për Mospërmbarim dhe përgjigjet e pranuara, përkatësisht: (i) theksimin e DHPGJS-së që ajo nuk ka kompetencë për të zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës përkundër faktit që thekson se i njëjti detyrimisht duhet të zbatohet bazuar në nenin 116 të Kushtetutës; (ii) qëndrimin e Komunës së Deçanit, pas kërkesës së Manastirit të Deçanit të vitit 2017 për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës, se "*me rastin e marrjes së vendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kuvendi Komunal i Deçanit ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme dhe ka marrë vendime në të cilat e kundërshton zbatimin e këtyre vendimeve dhe decidivisht është thënë se Drejtoria për Kadastër në Deçan dhe Agjencia Kosovare e Gjeodezisë të mos i zbatojë vendimet e lartpërmendura*"; (iii) qëndrimin e Komunës së Deçanit bazuar në shkresën e 1 shtatorit 2021 drejtuar AKK-së se e njëjta *"në vazhdimësi është shprehur dhe ka deklaruar mos pajtueshmërinë e sajë me Aktgjykimin KI132/15 dhe si pasojë nuk ka asnjë arsye e asnjë obligim dhe nuk merr përsipër zbatimin e këtij Aktgjykimi"*; dhe (iv) faktin se AKK, përkundër ankesave të vazhdueshme të Manastirit të Deçanit dhe përtej Aktvendimit [03/3539/20] të 17 dhjetorit 2020 përmes të cilit e kishte detyruar Zyrën Kadastrale Komunale që të marrë një vendim lidhur me këtë çështje dhe refuzimin e së njëjtës për të vepruar bazuar në Aktvendimin e AKK-së, nuk ka nxjerrë ndonjë vendim tjetër, duke u shtuar se për këtë kishte pranuar një shkresë nga Kryetari i Komunës së Deçanit, përmes së cilës është kërkuar që të mos procedohet kjo lëndë "*derisa të përfundojnë të gjitha negociatat që kanë filluar lidhur me pronat e kontestuara*".

29. Gjykata vëren se pas nxjerrjes së Aktgjykimit të saj në vitin 2016, janë zhvilluar në sërë procedurash për më tepër se pesë (5) vite dhe të cilat kanë pasur vetëm efektin e moszbatimit të një Aktgjykimi përfundimtarë në kundërshtim me nenin 116 të Kushtetutës.

30. Gjykata në mënyrë të njëjtë ka vepruar edhe në raste të tjera dhe të cituara më lart, në të cilat ka vlerësuar se në kundërshtim më nenin 116 të Kushtetutës, vendimet e saj nuk janë zbatuar. Në shkresën drejtuar u.d. të Kryeprokurorit të Shtetit të 6 shkurtit 2015 përkitazi me rastin e Gjykatës KI187/13, Gjykata, ndër tjerash, kishte theksuar se përkundër faktit që qysh nga themelimi i Gjykatës "*pothuajse 99% të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese janë zbatuar*", Gjykata "*duke qenë e përkushtuar që të ndjek procedurat e zbatimit të vendimeve të*

saj deri në realizimin e plotë të të drejtave të parashtruesve që dalin nga vendimet e saj", identifikon rastet të cilat ende nuk kanë gjetur zbatim nga autoritetet përkatëse, duke u tërhequr vëmendjen *"institucioneve shtetërore që, në sajë të kompetencave dhe të detyrimeve kushtetuese që kanë, të sigurojnë mekanizma për ti zbatuar vendimet e saj, në përputhje të plotë me nenin 116.1 të Kushtetutës*". Ndërsa, në shkresën e drejtuar Kryeprokurorit të Shtetit të 28 majit 2019 përkitazi me rastin e Gjykatës KI08/09 dhe njoftimin përkatës për nxjerrjen e Vendimit për Mospërmbarim, ndër tjerash, kishte theksuar se "*mosekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përbën shkelje kushtetuese dhe është në kundërshtim me parimet bazë të sundimit të ligjit në një shtet ligjor dhe demokratik*".

31. Gjykata gjithashtu thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), bazuar në të cilën, Gjykata sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës interpreton të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, një ndër aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili, ndër tjerash, kërkon që vendimet përfundimtare të gjykatave duhet të zbatohen dhe të mos vihen në pikëpyetje.[20] Për më tepër, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, në mënyrë konsistente përcakton që e drejta për një proces të rregullt siç garantohet përmes nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe e cila është në mënyrë të drejtpërdrejtë e aplikueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës bazuar në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës së saj, do të ishte "*iluzore*" nëse sistemet ligjore vendore do të "*lejonin një vendim gjyqësor përfundimtar të mbetej i pazbatuar në dëm të një pale*" dhe do të ishte e "*paimagjinueshme që nenin 6 të përshkruaj në detaje garancitë procedurale të palëve – procedura të drejta, publike dhe të shpejta – pa i dhënë mbrojtje zbatimit të vendimeve gjyqësore*".[21] Situata të tilla do të ishin në kundërshtim të hapur me parimin e sundimit të ligjit të cilin shtetet kontraktuese e kanë marrë për detyrë ta respektojnë bazuar në KEDNJ-në.

---

[20] Shih, ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *Guðmundur Andri* Ástráðsson *v. Island,* kërkesa nr.23674/18*,* Aktgjykim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së i 1 dhjetorit 2020, paragrafi 238; *Brumărescu v. Rumani*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së i 28 tetorit 1999, paragrafi 61; si dhe *Agrokompleks v. Ukraine*, kërkesa nr. 23465/03, Aktgjykim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së i 25 korrik 2013, paragrafi 148.

[21] Shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së *Romashov v. Ukraine*, kërkesa nr.67534/01, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 24 korrikut 2004, paragrafi 42.

32. Gjykata, për më tepër, rikujton që Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 3 [Barazia para Ligjit] të saj përcakton që Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Për më tepër, Kushtetuta në nenin 7 [Vlerat], gjithashtu përcakton që rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut. Sundimi i ligjit është po ashtu element që e reflekton trashëgiminë e përbashkët evropiane siç është përcaktuar në preambulën e KEDNJ-së dhe Kartën për të Drejtat Fondamentale të Bashkimit Evropian dhe është objektivë thelbësore e reflektuar në Statutin e Komisionit të Venecias.[22]

33. Marrë parasysh parimet e lartcekura, dhe pasi bazuar në shkresat e dorëzuara para saj, Gjykata ka konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI132/15 nuk është zbatuar nga autoritet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 116 të Kushtetutës dhe rregullin 66 të Rregullores së punës, Gjykata nxjerrë këtë Aktvendim për Mospërmbarim përkitazi me rastin e Gjykatës KI132/15. Në të njëjtën kohë, Gjykata gjithashtu e njofton Prokurorin e Shtetit përkitazi me moszbatimin e Aktgjykimit të saj në rastin KI132/15.

34. Në fund, duhet të theksohet se përtej konstatimit të moszbatimit të një Aktgjykimi, përmes Aktvendimit për Mospërmbarim dhe Njoftimit përkatës të Prokurorit të Shtetit, Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë për vlerësimin e përgjegjësisë për moszbatim të një vendimi të Gjykatës nga autoritetet përgjegjëse. Kompetenca për një vlerësim të tillë më pas i takon Prokurorit të Shtetit, bazuar në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

---

[22] Shih, ndër tjerash, (i) Preambulën e KEDNJ-së; (ii)Preambulën e Kartës për të Drejtat Fondamentale të Bashkimit Evropian; si dhe (iii) Statutin e Komisionit të Venecias.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 19 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe me rregullin 66 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 22 shtator 2021, njëzëri:

VENDOSI

I. TË KONSTATOJË që Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KI132/15, me parashtrues *Manastiri i Deçanit*, i datës 19 maj 2016 **nuk është zbatuar** nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Kosovës;

II. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim për Mospërmbarim përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KI132/15;

III. T'UA KOMUNIKOJË palëve këtë Aktvendim për Mospërmbarim;

IV. TË NJOFTOJË Prokurorin e Shtetit për nxjerrjen e këtij Aktvendimi për Mospërmbarim;

V. Në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe për qëllime të rregullit 66 (6) të Rregullores së punës, ky vendim do të publikohet në Gazetë Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në ueb-faqe zyrtare të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

KI82/21, Parashtrues: Komuna e Gjakovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, UPP-APP. nr. 1/2020, të 28 tetorit 2020

KI82/21, Aktgjykim i 9 shtatorit 2021, publikuar më 5 tetor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*

Nga shkresat e lëndës rezulton që pala e interesuar, A.R, ishte i punësuar në Komunën e Gjakovës në pozitën Avokat Publik Komunal, duke filluar nga viti 2008. Përderisa ishte duke e ushtruar këtë funksion, Komuna e Gjakovës kishte pranuar njoftime nga Prokuroria për fillimin e veprimeve hetimore ndaj tij si rezultat i dyshimit për kryerjen e disa veprave penale. Për pasojë, Kryetarja e Komunës së Gjakovës, kishte pezulluar personin A.R nga funksioni përkatës. Ankesa e tij kundër vendimit për pezullim të Komunës së Gjakovës në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ishte refuzuar. Pala A.R kishte iniciuar procedura në gjykatat e rregullta e të cilat kishin kthyer çështjen në rivendosje në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës dhe i cili sërish vërtetoi vendimin e lartcekur të Komunës për pezullimin nga detyra të personit A.R. Në ndërkohë, në procedurën penale, pala A.R ishte shpallur fajtor për veprën penale të konfliktit të interesit përmes Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Si rezultat, Komuna e Gjakovës filloi procedurën disiplinore, si rezultat i së cilës, pala A.R, u largua nga puna. Përkitazi me këtë vendim, ishin zhvilluar procedura në Gjykatën Themelore, të Apelit dhe Supreme, respektivisht dhe të cilat përfundimisht e refuzuan kërkesën e palës A.R. Megjithatë, ky i fundit, parashtroi kërkesë për përsëritje të procedurës e cila u miratua më 28 tetor 2020, përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të kontestuar para Gjykatës nga Komuna e Gjakovës në rrethanat e këtij rasti.

Komuna e Gjakovës para Gjykatës pretendoi shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar përmes Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kryesisht duke u fokusuar në cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe parimit të barazisë së armëve në procedurë, sepse sipas pretendimit, Gjykata Supreme, kishte vendosur sipas kërkesës së palës A.R, pa e njoftuar Komunën e Gjakovës, duke i pamundësuar dhe mohuar të njëjtës paraqitjen e përgjigjes në kërkesë dhe kundërargumentet përkatëse.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe përgjigjes përkatëse të palës A.R., Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkitazi me parimin e kontradikoritetit dhe barazisë së armëve, dhe

më pas aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata, ndër tjerash, ritheksoi se parimi i "*barazisë së armëve*" kërkon "*një baraspeshë të drejtë ndërmjet palëve*", ku secilës palë duhet dhënë mundësia e arsyeshme për të paraqitur rastin e vet, në kushte që nuk e vënë atë në pozitë konsiderueshëm të pabarabartë ndaj palës kundërshtare. Në këtë kuptim, Gjykata konstatoi që Gjykata Supreme duke vendosur mbi kërkesën për përsëritje të procedurës të dorëzuar nga pala A.R, pa e njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës tjetër, përkatësisht Komunës, për të paraqitur kundërargumentet përkitazi me një kërkesë të tillë, ka dështuar të garantojë zbatimin e parimit të barazisë se armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural. Gjykata gjithashtu theksoi se përtej garancive kushtetuese, ligjet e aplikueshme gjithashtu qartazi përcaktojnë detyrimin ligjor për dërgimin e kërkesës për përsëritje të procedurës edhe palës së kundërt dhe personave të interesuar, detyrim ky i cili ishte anashkaluar në rrethanat e rastit konkret.

Për pasojë dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejtat në proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke e kthyer të njëjtin në rishqyrtim në Gjykatën Supreme.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI82/21

Parashtrues

Komuna e Gjakovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, UPP-APP. nr. 1/2020, të 28 tetorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Vjollca Shyti (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [UPP.APP-1/2020] e 28 tetorit 2020 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme).

3. Parashtruesi i kërkesës, Aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 12 prill 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, i cili, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të

tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNj).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 29 prill 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përmes postës kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese.

8. Më 18 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

9. Më 24 maj 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi plotësimin e formularit të kërkesës së Gjykatës, si dhe autorizimin specifik për përfaqësim në Gjykatë.

10. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

11. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu Krasniqi si anëtare të Kolegjit shqyrtues

në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu. Gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi u caktua kryesuese e Kolegjit shqyrtues.

12. Më 1 qershor 2021, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, dorëzoi kërkesë për dhënie të informatave lidhur me kërkesën KI82/21.

13. Më 8 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama–Hajrizi, përmes Vendimit Nr. KI82/21, caktoi gjyqtarin Radomir Laban si gjyqtar raportues në vend të gjyqtares Gresa Caka-Nimani.

14. Më 11 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës përmes emailit dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar si dhe autorizimin specifik për përfaqësim në Gjykatë.

15. Më 24 qershor 2021, Gjykata e njoftoi palën e interesuar, Afrim Radoniqi, për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtit i ofroi një kopje të kërkesës.

16. Më 24 qershor 2021, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi informata se: *(1) a e keni njoftuar Parashtruesin e kërkesës, në këtë rast Komunën e Gjakovës, lidhur me propozimin për përsëritje të procedurës? Cili është detyrimi ligjor për një lajmërim të tillë?; dhe (2) Parashtruesi i kërkesës – Komuna e Gjakovës, pretendon se Gjykata Supreme ka lejuar përdorimin e një mjeti juridik të palejuar, pasiqë përsëritja e Procedurës nuk përcaktohet në Ligjin për Konfliktet Administrative, por vetëm. Cili është qëndrimi i Gjykatës Supreme lidhur me këtë pretendim të Komunës së Gjakovës?*

17. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

18. Më 1 korrik 2021, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, dorëzoi në Gjykatë komentet e tij lidhur me rastin KI82/21.

19. Më 2 korrik 2021, Gjykata Supreme ktheu përgjigje në kërkesën e Gjykatës për informata shtesë.

20. Më 7 korrik 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të njoftojë Gjykatën lidhur me datën kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

21. Më 9 korrik 2021, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës fletëkthesën që tregon se parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 12 prill 2021.

22. Më 9 shtator 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

23. Fillimisht, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, ishte palë në Gjykatë edhe në rastin KI32/17, në të cilin objekt shqyrtimi ishte Aktgjykimi [Pml.nr.276/2016] i 5 dhjetorit 2016 i Gjykatës Supreme. Në këtë rast Gjykata përmes Aktvendimit për papranushmëri kishte vendosur që kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

24. Nga shkresat e lëndës rezulton që pala e interesuar, Afrim Radoniqi, ishte i punësuar në Komunën e Gjakovës në pozitën Avokat Publik Komunal, duke filluar nga viti 2008. Gjatë kohës përderisa pala e interesuar ishte duke punuar, Komuna e Gjakovës kishte pranuar njoftime nga Prokuroria për fillimin e veprimeve hetimore ndaj tij për kryerje të veprave penale gjatë ushtrimit të funksionit të tij, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 434 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK-së), veprës keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprës penale konflikt i interesit nga neni 424 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 të KPRK-së. Rrjedhimisht, më 25 mars 2014, Kryetarja e Komunës përmes Vendimit [01 Nr. 118-2664] vendosi që të pezullojë Afrim Radoniqin me pagesë 50% të rrogës së tij, deri në marrjen e një vendimi nga Gjykata, dhe se punëdhënësi pas përfundimit të procedurës gjyqësore do të veprojë sipas ligjit për shërbimin civil të Kosovës. Ndaj Vendimit të Komunës së Gjakovës, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMSHCK).

25. Më 22 tetor 2014, KPMSHCK përmes Vendimit [Nr. A.02/354/2014] refuzoi si të pabazuar ankesën e palës së interesuar Afrim Radoniqi, duke e lënë në fuqi Vendimin e lartcekur për pezullim parandalues të Komunës së Gjakovës.

26. Më 18 nëntor 2014, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, përmes padisë kishte kërkuar nga Gjykata Themelore që të anulohet Vendimi [Nr. A. 02/354/2014] i të paditurës KPMSHCK, i 22 tetorit 2014, me të cilin i

ishte refuzuar ankesa kundër vendimit [nr. 118-2624/2014] të Kryetares së Komunës së Gjakovës të 25 marsit 2014 për pezullim parandalues. Ai pretendonte që Vendimi i KPMSHCK ishte i përfshirë me shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrativ¢ dhe Rregullores për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave.

27. Më 15 korrik 2016, KPMSHCK, në cilësinë e të paditurës dorëzoi përgjigje në padi duke kundërshtuar padinë e lartcekur nën pretendimin se e njëjta nuk rezulton nga faktet dhe provat e prezantuara dhe se me asnjë provë paditësi nuk ka mundur të argumentojë pretendimet c tij, duke propozuar që ta refuzojë padinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa të vërtetojë vendimin e saj.

28. Më 13 shtator 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [A.nr.2306/14] vendosi që të: (i) Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e palës së interesuar Afrim Radoniqi; dhe (ii) Anulohet vendimi [A/02/354/2014] i 22 tetorit 2014, i të paditurës-KPMSHCK dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

29. Në një datë të paspecifikuar, KPMSHCK parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të: (i) shkeljeve thelbësore në procedurë; (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) zbatimit të gabuar të ligjit material me propozimin që të shfuqizohet Aktgjykimi i lartcekur dhe të mbetet në fuqi vendimi [A/02/354/2014] i 22 tetorit 2014 i KPMSHCK-së. Përgjigje në ankesë parashtroi pala e interesuar, Afrim Radoniqi, me propozimin që ankesa e KPMSHCK të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i lartcekur të vërtetohet.

30. Më 21 mars 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr. 20/2017] refuzoi si të pabazuar ankesën e të paditurit KPMSHCK, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore vërtetohet.

31. Më 15 maj 2017, në procedurën për rishqyrtim dhe rivendosje, KPMSHCK përmes Vendimit [A/02/436/2016] vendosi: (i) të refuzojë si të pabazuar ankesën e 22 gushtit 2014, të dorëzuar nga pala e interesuar, Afrim Radoniqi; dhe (ii) e la në fuqi Vendimin mbi pezullimin [01 Nr. 118-2664) e 25 marsit 2014, të Komunës së Gjakovës.

Procedura e propozimit për Përmbarim të Aktgjykimit [AA.nr.20/2017] të 21 marsit 2017, të Gjykatës së Apelit

32. Më 2 nëntor 2017, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, parashtroi propozim për përmbarim kundër parashtruesit të kërkesës, Komunës

së Gjakovës, për përmbarimin e dokumentit përmbarimor, Aktgjykimin [A.nr.2306/14] e 13 shtatorit 2016 të vërtetuar me Aktgjykimin [AA.nr.20/2017] e 21 marsit 2017, të Gjykatës së Apelit.

33. Më 8 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës, Komuna e Gjakovës, dorëzoi prapësimin kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit duke theksuar se: (i) Gjykata Themelore nuk ka kompetencë lëndore që të lejojë përmbarimin e propozuar; (ii) ekzekutimin e vendimeve administrative e bën organi kompetent i Administratës. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës theksonte se propozimi për përmbarim është i parakohshëm dhe pa objekt të përmbarimit, sepse përmes Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nuk ia njeh të drejtën e kreditorit Afrim Radoniqi, por ishte vendosur që çështja t'i kthehet KPMSHCK-së për rishqyrtim dhe rivendosje. Përgjigje në prapësim nuk parashtroi pala e interesuar, Afrim Radoniqi.

34. Më 26 dhjetor 2017, Gjykata Themelore në Gjakovë përmes Aktvendimit [CP.nr.279/17] aprovoi si të bazuar: (i) prapësimin e debitorit, Komunës së Gjakovës, e 8 dhjetorit 2017; dhe (ii) anuloi Aktvendimin për përmbarim të Gjykatës Themelore [CP.nr.279/17] të 2 nëntorit 2017, dhe i prishi të gjitha veprimet përmbarimore të marra nga e njëjta.

Procedura penale ndaj Afrim Radoniqi dhe largimi nga puna

35. Më 18 korrik 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë, përmes Aktgjykimit [PKR.nr.105/15] palën e interesuar, Afrim Radoniqi: (i) e liroi nga akuza për veprën penale falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 434 paragrafi 1 i Kodit Penal; (ii) e liroi nga akuza për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK-së; (iii) e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale konflikti i interesit nga neni 424 paragrafët 1 dhe 4 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 3000 EUR e të cilin dënim i akuzuari ishte i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

36. Më 9 gusht 2016, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, parashtroi ankesë kundër pikës III të Aktgjykimit të lartcekur, për shkak të: (i) shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale; (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; (iii) shkeljes së Ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozimin që të aprovojë ankesën e tij si të bazuar; si dhe (iv) të ndryshojë pikën III të Aktgjykimin të lartcekur, apo të marrë vendim që çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje.

37. Më 20 shtator 2016, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.497/16] vendosi që: (i) me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së palës së interesuar, Afrim Radoniqi, ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë [PKR.nr. 105/15] i 18 korrikut 2016, vetëm përkitazi me vendimin mbi sanksionin penal ashtu që të akuzuarit për vepër penale Konflikti i interesit nga neni 424 paragrafi 1 lidhur me paragrafi 4 të KPRK-së, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 2000 (dy mijë) Euro, e të cilën gjobë është i obliguar që ta paguajë në afat prej (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi; (ii) në pjesën liruese aktgjykimi mbetet i paprekur.

Procedura e largimit nga puna të palës së interesuar, Afrim Radoniqi

38. Komuna e Gjakovës, në bazë të Aktgjykimit [PAKR.nr.497/16] të Gjykatës së Apelit, inicioi procedurë disiplinore ndaj Afrim Radoniqit. Pra, më 7 mars 2017, Komisioni Disiplinor në Komunën e Gjakovës përmes Vendimit [01/070-01/2927] vendosi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, përderisa pala e interesuar, Afrim Radoniqi, ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale konflikti i interesit.

39. Më 30 mars 2017, pala e interesuar kishte dorëzuar ankesë kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës.

40. Më 5 maj 2017, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjakovës, përmes Vendimit [01-070-7914] konstatoi që Vendimi [01/070-01/2927] i Komisionit Disiplinor, i 7 marsit 2017 është në pajtim me paragrafin 4 të nenit 63 (përgjegjësitë) të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se *"Nëse nëpunësi civil shpallet fajtor dhe dënohet për kryerje të veprës penale, autoritetet kompetente administrative detyrohen që nga ato elemente të vendimit të gjykatës kompetente, që përbëjnë shkelje të parimeve dhe të rregullave administrative, duhet të urdhërojnë shkarkimin e nëpunësit civil"*.

41. Në një datë të paspecifikuar, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, kishte parashtruar ankesë në KPMSHCK ndaj Vendimit të lartcekur të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjakovës, me kërkesën që të kthehet në punë.

42. Më 18 korrik 2017, KPMSHCK përmes Vendimit [A/02/250/2017] e refuzoi ankesën e palës së interesuar dhe vërtetoi vendimet e

Komisionit Disiplinor dhe Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjakovës.

43. Më 17 gusht 2017, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë me kërkesën e anulimit të vendimeve të të paditurit KPMSHCK, përkatësisht: (i) Vendimit [A/02/436/2016] të 15 majit 2017 (të përmendur në paragrafin 30, me të cilin ishte vërtetuar Vendimi i Kryetares së Komunës për pezullim); dhe (ii) Vendimit [A/02/250/2017] të 18 korrikut 2017 (me të cilin ishte lënë në fuqi Vendimi [01-070-7914] i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave).

44. Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) fillimisht bëri bashkimin e dy lëndëve, pasiqë objekti i kërkesëpadisë dhe palët ishin të njëjta, dhe më 9 gusht 2018, përmes Aktgjykimit [A.nr. 975/2017] vendosi që të: (i) Aprovohet pjesërisht si e bazuar, kërkesëpadia e palës së interesuar, Afrim Radoniqi; (ii) Anulohet Vendimi [A02/250/20 17] i 18 korrikut 2017, i të paditurit KPMSHCK-së dhe vendimet e Komunës së Gjakovës, Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave [nr.01-070-7914], të 5 majit 2017 dhe Vendimi i Komisionit Disiplinor [01-070-01-2927] i 7 marsit 2017 dhe detyrohet Komuna e Gjakovës që paditësin, Afrim Radoniqi, të kthejë në vendin e punës, Avokat Publik Komunal me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës sipas Akt emërimit [01-118-143-9] të 1 qershorit 2013 nga momenti i largimit nga marrëdhënia e punës sipas vendimit të Komunës së Gjakovës të 7 marsit 2017; (iii) Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë së paditësit, me të cilin ka kërkuar anulimin e Vendimit [A02/436/2017] të 15 majit 2017 të paditurit, KPMSHCK-së dhe Vendimit të Komunës së Gjakovës [118-2624/2014], të 25 marsit 2014, si e pa bazuar.

45. Më 14 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës, Komuna e Gjakovës, dorëzoi ankesë kundër pjesës aprovuese, përkatësisht pikës I dhe II të dispozitivit të Aktgjykimit të lartcekur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit të aprovojë si të bazuar ankesën e parashtruar nga ai dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

46. Më 17 shtator 2018, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, dorëzoi ankesë kundër pikës III të Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, për shkak të cenimit të dispozitave të procedurës gjyqësore; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa të aprovohet si e bazuar,

të ndryshohet pika III e Aktgjykimit [A.nr. 975/18] të Gjykatës Themelore, të obligohet Komuna e Gjakovës që paditësit Afrim Radoniqi t'ia kompensojë të ardhurat personale të papaguara në lartësi prej 50% duke llogaritur kamatën ligjore duke filluar nga 25 marsi 2014 e deri më 5 maj 2017 si dhe, kompensimin e të gjitha benefiteve të tjera nga marrëdhënia e punës.

47. Më 21 shtator 2018, KPMSHCK dorëzoi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës administrative; vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i ankimuar të anulohet si i pabazuar në ligj.

48. Më 26 shtator 2018, Komuna e Gjakovës dorëzoi përgjigje në ankesë, duke theksuar se Gjykata Themelore me rastin e vendosjes në pikën III të Aktgjykimit të saj, ka dhënë arsye të mjaftueshme, të qarta dhe të bazuara në dispozitat ligjore dhe se drejtë ka aplikuar të drejtën materiale.

49. Më 5 nëntor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA.nr.505/2018]: (i) refuzon si të pabazuar ankesën e palës së interesuar, Afrim Radoniqi, të 17 shtatorit 2018, ndërsa vërteton pikën III të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore; (ii) aprovon si të bazuara ankesat e të paditurit KPMSHCK-së dhe të parashtruesit të kërkesës, Komunës së Gjakovës, ndërsa pika II e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore prishet dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje; dhe (iii) Në pjesën tjetër, dispozitivi i Aktgjykimit të ankimuar mbetet i pandryshueshëm.

50. Më 29 nëntor 2019, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të Aktvendimit [AA.nr.505/2018] të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet kërkesa dhe të ndryshohet aktvendimi i atakuar.

51. Më 16 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës, Komuna e Gjakovës, përmes përgjigjes në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, i kontestoi në tërësi pretendimet e palës së interesuar, Afrim Radoniqi, me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

52. Më 20 janar 2020, Gjykata Supreme e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) përmes Aktvendimit [ARJ-UZVP.nr.15/2020] e hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e palës së interesuar, Afrim Radoniqi, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor,

paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [AA.nr. 505/2018] të 9 gushtit 2018. Në arsyetimin e saj Gjykata Supreme thekson se: *"[...] me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit [AA.nr.505/2019] të 5 nëntorit 2019, në pikën II të Aktvendimit, është anuluar Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë [A.nr.975/2017] të 9 gushtit 2018 dhe çështja i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje. Meqenëse, vendimi gjyqësor nuk është bërë i plotfuqishëm, pasi që lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, kjo Gjykatë e ka hedhur kërkesën si të palejueshme".*

53. Pala e interesuar, Afrim Radoniqi, parashtroi kërkesë për përsëritje të procedurës me të cilën konteston ligjshmërinë e Aktvendimit [ARJ-UZVP nr.15/2020] të 20 janarit 2020, të Gjykatës Supreme. Pala e interesuar pretendon që me Aktvendimin e kontestuar, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendit gjyqësor, me të cilin pala e interesuar, Afrim Radoniqi, e kishte kontestuar vendimin e shkallës së dytë në pjesën ku është vërtetuar vendimi i shkallës së parë, me të cilin është refuzuar ankesa e palës së interesuar për tu anuluar Aktvendimi [A/02/436/2017] i 15 majit 2007 i KPMSHCK-së, e vendosur në pjesën me të cilën është anuluar vendimi i shkallës së parë nga ana e gjykatës së shkallës së dytë dhe nuk është vendosur në pjesën ku është refuzuar ankesa e paditësit.

54. Më 28 tetor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [UPP-APP.nr.1/2020] lejoi si të bazuar propozimin për përsëritje të procedurës të paditësit Afrim Radoniqi, parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Supreme [ARJ-UZVP.nr.15/2020] të 20 janarit 2020, kështu që anulohet Aktvendimi i cekur.

55. Më 14 maj 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A.nr.2691/2019] aprovon si të bazuar propozimin e Komunës së Gjakovës, të dhënë në parashtresën e 11 majit 2021, dhe ndërpritet procedura sipas padisë së Afrim Radoniqit, deri sa Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të vendosë lidhur me ankesën e Komunës së Gjakovës të 28 prillit 2021, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [UPP-APP.nr. 1.2020] të 28 tetorit 2020.

Komentet e palës se interesuar Afrim Radoniqi

56. Më 24 qershor 2021, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë thekson që *"ankesa e parashtruesit të kërkesës-Komunës së Gjakovës në Gjykatën Kushtetuese është keqpërdorim i të drejtave procedurale dhe, ka të*

vetmin qëllim që sa më gjatë të prolongohet vendosja meritore e kontestit të punës i cili kontest është filluar që nga viti 2014 dhe se për të njëjtin objekt të kërkesëpadisë deri më tani janë nxjerrë gjithsej 5 (pesë) Aktgjykime/ Aktvendime nga gjykata e shkallës së parë, të dytë dhe të tretë që rezulton me shkelje të dispozitave të Kushtetutës, përkatësisht të Neni 34 (E drejta për të mos u gjykuar dy (2) herë për të njëjtën çështje)".

Përgjigja e Gjykatës Supreme të Kosovës

57. Më 2 korrik 2021, Gjykata pranoi nga Gjykata Supreme përgjigjet në pyetjet e parashtruara: *(1) a e keni njoftuar Parashtruesin e kërkesës, në këtë rast Komunën e Gjakovës, lidhur me propozimin për përsëritje të procedurës? Cili është detyrimi ligjor për një lajmërim të tillë?; dhe (2) Parashtruesi i kërkesës – Komuna e Gjakovës, pretendon se Gjykata Supreme ka lejuar përdorimin e një mjeti juridik të palejuar, pasiqë përsëritja e Procedurës nuk përcaktohet në Ligjin për Konfliktet Administrative, por vetëm. Cili është qëndrimi i Gjykatës Supreme lidhur me këtë pretendim të Komunës së Gjakovës?*

58. Gjykata Supreme, lidhur me përgjigjen në pyetjen e parë (1), theksoi që: *"sa i përket informatave të kërkuara konstatuam se paditësi iu ka drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për rishikimin e aktvendimit [ARJ-UZVP.nr.15/2020] me 20.10.2020, për shkaqe sipas paditësit se Gjykata Supreme në mënyrë të gabuar ka proceduar dhe ka rishqyrtuar pikën II të dispozitivit të aktvendimit AA. UZH.nr.505/2018 dt.05.11.2019, të Gjykatës së Apelit.*

Në shkresat e lëndës Komuna e Gjakovës nuk ka qenë palë në procedurë dhe nuk ka evidence se të njëjtës iu ka dërguar kjo kërkesë. "

59. Gjykata Supreme lidhur me përgjigjen në pyetjen e dytë (2) theksoi që: *"Sa i përket informatave për piken 2) të kërkesës tuaj, si administratë e gjykatës nuk mund të komentojmë vendimin gjyqësor të kolegjit të kësaj gjykate dhe të japim ndonjë përgjigje profesionale sa i përket pretendimeve të Komunës së Gjakovës, se a lejohet përdorimi i këtij mjeti juridik, kjo është çështje e vlerësimit profesional dhe kompetencë e kolegjit të gjyqtarëve. Qëndrimi i kësaj gjykate është sipas aktgjykimit të kontestuar deri sa të vërtetohet e kundërta".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

60. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar [UPP-APP.nr. 1/2020] i 28 tetorit 2020 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar janë cenuar: (i) parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve në procedurë; dhe (ii) parimi i sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

(i) Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në procedurë

61. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës thekson se përderisa pala e interesuar, Afrim Radoniqi, ka paraqitur kërkesë për përsëritjen e procedurës, e njëjta do të duhej t'i dërgohej parashtruesit të kërkesës, përkatësisht Komunës së Gjakovës, pasiqë të njëjtit kishin statusin e *"palës së interesuar"* në tërë procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta. Rrjedhimisht, parashtruesit të kërkesës, Komunës së Gjakovës, i është pamundësuar dhe mohuar paraqitja e përgjigjes në atë kërkesë dhe i është pamundësuar paraqitja e kundër-provave.

62. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës thekson se si rezultat i mosnjoftimit të Komunës së Gjakovës me propozimin e paditësit për përsëritjen e procedurës është shkelur parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural. Parashtruesi i kërkesës thekson se sipas GjEDNj-së, neni 6.1. i Konventës i detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të duhur të parashtresave dhe argumenteve si dhe provave të paraqitura nga palët në procedurë, pa paragjykuar se cili do të jetë ndikimi i tyre për vendimin e gjykatës (shih, ngjashëm GjEDNj, rastin *Kraska kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1993; *Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988).

63. Parashtruesi i kërkesës thekson se në një situatë të tillë analogjike, Gjykata Kushtetuese kishte vendosur me Aktgjykim në rastin nr. KI193/19, me parashtrues *Salih Mekaj*. Sipas parashtruesit të kërkesës, në përmbledhjen e këtij Aktgjykimi, Gjykata kishte theksuar se parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural, si elemente qenësore të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm kërkojnë që gjykatat të vendosin një ekuilibër të drejtë në mes të palëve në procedurë, si dhe t'iu mundësohet atyre që të kenë

një ballafaqim përmbajtësor të pretendimeve dhe argumenteve.

64. Pra, parashtruesi i kërkesës në vijim thekson që analogjia në mes të rasteve lidhur me shkeljet në procedurë që i kanë paraprirë Aktgjykimit të kontestuar dhe të rastit KI193/19, me parashtrues *Salih Mekaj* është prezente. Neni 6 i KEDNj-së [E drejta për një proces të rregullt] në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile thekson se "çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme".

(ii) Përkitazi me pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor

65. Parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se Vendimi i kontestuar është arbitrar, që shkel parimin e sigurisë juridike, pasiqë i njëjti në arsyetimin e vendimit të kontestuar nuk është përmendur asnjë arsyetim lidhur me lejimin e përsëritjes së procedurës. Veprimi i tillë, përkatësisht heshtja, mangësia totale e arsyetimit të lejueshmërisë së kërkesës për përsëritje të procedurës nga Gjykata Supreme, është veprim kundër kushtetues.

66. Në vijim, parashtruesi thekson se Gjykata Kushtetuese në një vendim të saj ka gjetur se funksioni i një vendimi të arsyetuar, sipas GjEDNj-së, është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për të apeluar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë (shih *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, 27 shtator 2001, paragrafi 30; *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58; rastin e Gjykatës K197116, parashtrues *"IKK Classic"*, Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 46; dhe KI22/16, *N. Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017, paragrafi 40). Për shkak të mos njoftimit të Komunës së Gjakovës me propozimin e paditësit për përsëritjen e procedurës është shkelur parimi i barazisë se armeve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural. Sipas GjEDNj-së, neni 6.1. i Konventës i detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të duhur të parashtresave dhe argumenteve si dhe provave të paraqitura nga palët në procedurë, pa paragjykuar se cili do të jetë ndikimi i tyre për vendimin e gjykatës (shih, ngjashëm GjEDNj, rastin *Kraska kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1993; *Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988). Sipas parashtruesit të kërkesës, ky

lëshim i Gjykatës Supreme është bazë e mjaftueshme që Gjykata Kushtetuese të aprovojë këtë ankesë kushtetuese.

67. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson që Aktgjykimi i kontestuar në dispozitivin e tij thekson: *"Lejohet si i bazuar propozimi për përsëritje të procedurës së paditësit, ...* ", ndërsa sipas Ligjit për Konfliktet Administrative, nuk parashihet institucioni juridik i përsëritjes së procedurës. Aplikimi i këtij institucioni inekzistent në procedurën e konfliktit administrativ, nuk është i përcaktuar, pasiqë në Ligjin nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, në nenin 55, parashihet rishikimi (jo përsëritja e procedurës).

68. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme në këtë procedurë, meqë nuk kishte bazë juridike e as faktike për te rishikuar procedurën apo për të përsëritur procedurën, nuk ka dhënë asnjë bazë juridike për rishikim nga neni 55 i LKA-së. Mangësia absolute e arsyeve se pse është lejuar *"propozimi për përsëritje të procedurës"* paraqet bazë të mjaftueshme faktike dhe juridike që Aktgjykimin e atakuar e bën të kundërligjshëm, krijon pasiguri juridike që paraqet shkelje të parimeve themelore kushtetuese.

69. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson që edhe për rishikim të përcaktuar në nenin 55 të LKA-së, nuk ka bazë për lejueshmërinë e tij, pasiqë Gjykata Supreme do të duhej të shqyrtonte kushtet e lejueshmërisë dhe efektshmërisë të përcaktuara me nenin 55.2 dhe nenet 56 dhe 57 të LKA-së. Ndërsa, Gjykata Supreme është mjaftuar me dhënien e një arsyetimi të përgjithshëm: *"Meqë me këtë aktgjykim është anuluar aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ UZVP. nr. 15/2020] i 20 janarit 2020, me të cilin është hedhur poshtë kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, si e palejuar, kjo gjykatë duke vlerësuar arsyet e paditësit të dhëna në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ka gjetur se të njëjtat janë të bazuara".*

70. Në të njëjtën linjë argumentimi, parashtruesi i kërkesës thekson që Gjykata Kushtetuese duhet të vendos në këtë çështje se Gjykata Supreme e Kosovës e ka *"aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar"* dhe për pasojë ka pasur konkluzione arbitrare dhe qartazi të paarsyeshme ndaj tij dhe se ky qëndrim arbitrar i Gjykatës Supreme krijon precedent të keq, të dëmshëm për sistemin ligjor në Republikën e Kosovës.

71. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (I) të deklarojë ankesën kushtetuese të pranueshme; (II) të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së,

përkatësisht shkeljes së parimit të gjykimit të drejtë nga neni 6 i KEDNj-së; nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, parimit të sigurisë juridike, mangësisë së arsyetimit të domosdoshëm të vendimit gjyqësor, shkeljes së parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit dhe i mos arsyetimit të vendimit gjyqësor; (III) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [UPP-APP.nr. 1/2020] të 28 tetorit 2020; (IV) të kthejë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [UPP-APP.nr. 1/2020] për rivendosje në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese; (V) të urdhërojë Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën Kushtetuese, sa më shpejtë që është e mundur dhe lidhur për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si

për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[....]

Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative

Neni 21

Pozitën e palës në konfliktin administrativ e ka edhe personi, të cilit, anulimi i aktit administrativ të kontestuar, do t'i sillte dëm të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Neni 30

1. Në padi duhen të përfshihen: emërtimi i gjykatës të cilës i paraqitet padia, emri, mbiemri dhe vendbanimi, respektivisht selia e paditësit dhe e të padituri, akti administrativ kundër të cilit është drejtuar padia, arsyet pse ngrihet padia, si dhe në cilin drejtim dhe vëllim propozohet anulimi i aktit administrativ. Bashkë me padinë duhet të bashkangjitet akti që kontestohet në origjinal ose kopje.

2. Nëse me padi kërkohet kthimi i sendit ose kompensimi i dëmit, duhet të shtrohet edhe kërkesa e caktuar në pikëpamje të sendit apo të shumës së dëmit të pësuar.

3. Bashkë me padi, paraqitet edhe nga një kopje e padisë dhe e dokumenteve të bashkëngjitura për organin e paditur dhe për çdo person të interesuar, nëse ekzistojnë të tillë.

Neni 55
Rishikimi

1. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, që ka marrë formë të prerë, kur:

1.1. pala mëson për fakte të reja, apo nëse konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja, në bazë të së cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë më të favorshme për të, po të ishin shtruar ose përdorur këto fakte, apo prova, në procedurën e mëparshme gjyqësore;

1.2. vendimi i gjykatës ka ardhur si pasojë e veprës penale të gjyqtarit apo punëtorit në gjykatë ose vendimi është nxjerrë me veprim mashtrues të përfaqësuesit ose të autorizuesit të palës, të kundërshtarit të tij ose të përfaqësuesit apo të autorizuesit të kundërshtarit, kurse ky veprim përbën vepër penale;

1.3. vendimi është bazuar në aktgjykimin e nxjerr në çështjen penale apo civile, kurse ky aktgjykim është anuluar më vonë me vendim gjyqësor të formës së prerë;

1.4. dokumenti në të cilin bazohet vendimi është i falsifikuar, apo nëse dëshmitari, eksperti, ose pala gjatë dëgjimit para gjykatës ka dhënë deklaratë të rreme, kurse vendimi i gjykatës është bazuar në këtë deklaratë;

1.5. pala konstaton apo krijon mundësi ta përdorë vendimin e mëparshëm të nxjerrë në të njëjtin konflikt administrativ; dhe

1.6. personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ.

2. Për shkak të rrethanave nga nën-paragrafi 1.1 dhe nën-paragrafi 1.5 i këtij paragrafi rishikimi do të lejohet vetëm nëse pala, pa faj të vet, nuk ka pasur mundësi që këto rrethana t'i shtrojë në procedurën e mëparshme.

Neni 60

1. Mbi kërkesë për rishikim gjykata vendos në seancë të mbyllur.

2. Gjykata do ta hedhë poshtë kërkesën me vendim nëse vërteton se kërkesën e ka paraqitur personi i paautorizuar ose kërkesa nuk është bërë në kohën e duhur, apo pala nuk e ka bërë të paktën të besueshme ekzistimin e bazës ligjore për rishikim.

3. Nëse gjykata nuk e hedh poshtë kërkesën sipas paragrafit 2. të këtij neni, do t'ia dërgojë palës së kundërt dhe personave të interesuar dhe do t'i ftojë që

brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh t'i përgjigjen kërkesës.

Neni 61

1. Pas skadimit të afatit për përgjigje në kërkesë për rishikim, gjykata vendos me aktgjykim mbi kërkesën për rishikim.

2. Nëse lejohet rishikimi, do të shfuqizohet vendimi i mëparshëm tërësisht ose pjesërisht.

3. Veprimet e mëparshme procedurale, të cilat nuk ndikojnë në shkaqet e rishikimit, nuk përsëriten.

4. Me aktgjykim, me të cilin lejohet rishikimi, do të vendoset edhe për çështjen kryesore.

Neni 63
Dispozita të tjera të procedurës

Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore.

Neni 53
[pa titull]

Gjykata vendos mbi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm ose kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, si rregull, në seancë të mbyllur, ndërsa vendimin e kundërshtuar e shqyrton vetëm brenda kufijve të kërkesës.

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 160
[pa titull]

160.1 Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet ta ketë: pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin mbi të drejtën e ankimit kundër aktgjykimit.
160.2 Pjesa hyrëse e aktgjykimit përmban: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit, emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë, tregimin e shkurtër

të objektit të kontestit dhe vlerën e tij, ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor, tregimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtimin e tillë si dhe ditën kur është dhënë aktgjykimi.
160.3 Dispozitivi i aktgjykimit përmban: vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale.
160.4 Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.
160.5 Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor.

160.6 Në pjesën arsyetuese të aktgjykimit kontumacional, aktgjykimit në bazë të pohimit, aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, apo të aktgjykimit për shkak të mungesës, jepen vetëm arsyet që e justifikojnë dhënien e aktgjykimeve të këtilla.

Neni 182

[...]

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

[...]

n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që

në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

72. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

73. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21

"[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

Neni 113

"*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

74. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

75. Fillimisht, Gjykata sqaron se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u referuar në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastet e Gjykatës, KI10/20, me parashtrues *"Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" SH. A. – Njësia Malësia e Re Prizren,* Aktvendim për Papranueshmëri i 5 tetorit 2020, paragrafi 35; rasti KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

76. Në vijim sa i përket përmbushjes së kritereve të mësipërme procedurale, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [UPP-APP.nr.1/2020] e 28 tetorit 2020 të Gjykatës Supreme dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

77. Në fund dhe pas shqyrtimit të ankesës kushtetuese të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashihet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih, gjithashtu rastin e GjEDNj-së: *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykim, i 9 korrikut 2012, paragrafi 144, si dhe shih në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës KI27/20, parashtrues *Lëvizja VETËVENDOSJE!*, Aktgjykim, i 22 korrikut 2020, paragrafi 43).

78. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të deklarohet e papranueshme në bazë të kritereve të përcaktuara në paragrafin (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Meritat e kërkesës

79. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar [UPP-APP.nr. 1/2020] i 28 tetorit 2020 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar janë cenuar: (i) parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve në procedurë; dhe (ii) parimi i sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor. Gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së këtyre pretendimeve, Gjykata gjithashtu do të zbatojë standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GjEDNj), në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

80. Gjykata, fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme atij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, përkatësisht parashtruesi specifikon se në rastin e tij janë cenuar: I. Parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve në procedurë, si rezultat i mosnjoftimit të tij për kërkesën për përsëritje të procedurës të ushtruar nga pala e interesuar, Afrim Radoniqi; dhe II. Parimi i sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, lidhur me arsyetimin për lejimin për propozimin e për përsëritje të procedurës të paditësit.

I. Përkitazi me pretendimin për shkeljen e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në procedurë

81. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendimin e tij për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit në mënyrë specifike e ndërlidhë me mosdërgimin e propozimit për përsëritje të procedurës të parashtruar nga pala e interesuar, Afrim Radoniqi, si dhe mos dhënies së mundësisë për të paraqitur përgjigje në këtë kërkesë.

82. Rrjedhimisht, në dritën e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme të zhvilluara në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve.

83. Në fund, Gjykata gjatë shqyrtimit dhe elaborimit të parimeve të përgjithshme të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GjEDNj-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve do të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse rastet e GjEDNj-së dhe të Gjykatës, të përmendura nga parashtruesi në kërkesën e tij i referohen rrethanave të ngjashme faktike dhe juridike si ato në rastin e tij dhe po ashtu do të vlerësojë nëse këto raste janë të aplikueshme në rastin e tij.

a. Parimet e përgjithshme sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GjEDNj-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve

84. Koncepti i një gjykimi të drejtë përfshin të drejtën themelore të pasurit gjykim bazuar në parimin e kontradiktoritetit. Njëkohësisht, ky parim është i lidhur ngushtë me parimin e barazisë së armëve (shih rastin e GjEDNj-së: *Regner kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 19 shtatorit 2017, paragrafi 146).

85. Gjykata duke iu referuar edhe praktikës së GjEDNj-së, fillimisht rithekson se parimi i *"barazisë së armëve"* është element i një koncepti më të gjerë të një gjykimi të drejtë (shih rastin e GjEDNj-së, *Borgers kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 12005/86, Aktgjykim i 30 tetorit 1991, paragrafi 24).

86. GjEDNj dhe Gjykata në praktikën gjyqësore ka theksuar se parimi i *"barazisë së armëve"*, kërkon *"ekuilibër të drejtë midis palëve"* ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në disavantazh substancial *vis-a-vis* palës kundërshtare (shih rastet e GjEDNj-së *Yvon kundër Francës,* kërkesa nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut

2003, paragrafi 31 dhe *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës,* kërkesa nr. 14448/88*,* Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33 shih dhe referencat tjera në këtë Aktgjykim, *Öcalan kundër Turqisë* [DHM], paragrafi 140, *Grozdanoski kundër ish-RJM*, kërkesa nr. 2150/03, Aktgjykim i 31 majit 2007, shih po ashtu rastet e Gjykatës: KI230/19, me parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 8 janarit 2021, paragrafi 98; KI239/19, me parashtrues *Hakif Veliu*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 marsit 2021, paragrafi 112; KI52/12, parashtruese *Adije Iliri*, Aktgjykim i 5 korrikut 2013, KI103/10, parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykim i 20 marsit 2012, paragrafi 40*)*.

87. Gjykata më tej rikujton se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka përcaktuar se kërkesa e barazisë së armëve, në kuptim të një ekuilibri të drejtë midis palëve, vlen në parim si për raste civile ashtu edhe për ato penale (shih rastin e GjEDNj-së: *Dombo Beher B.V. kundër Holandës*, Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33). Gjithashtu, kërkesat që rezultojnë nga e drejta për procedura kundërshtuese janë në parim të njëjtat si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale (shih rastin e GjEDNj-së: *Werner kundër Austrisë*, Aktgjykim i 24 nëntorit 1997, paragrafi 66).

88. Për më tepër, Gjykata gjithashtu thekson se gjykimi i drejtë gjithashtu përfshin të drejtën për gjykimin në pajtim me *"parimin e kontradiktoritetit",* parim i cili është i ndërlidhur me parimin e *"barazisë së armëve"*. Në këtë kontekst, në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së ka pasur një zhvillim të konsiderueshëm, veçanërisht në lidhje me rëndësinë që i kushtohet paraqitjeve dhe rritjes së vëmendjes apo ndjeshmërisë së publikut ndaj administrimit të drejtë të drejtësisë (shih rastin *Borgers kundër Belgjikës* të cituar më lartë, paragrafi 24).

89. E drejta për procedurë kontradiktore nënkupton në parim mundësinë që palët në një gjykim penal ose civil të kenë njohuri dhe të komentojnë mbi të gjitha provat e marra ose parashtresat e dorëzuara, madje edhe nga një anëtar i pavarur i shërbimit juridik kombëtar, me qëllim që të ndikojnë në vendimin e gjykatës (shih rastet e GjEDNj-së: *Ruiz-Mateos kundër Spanjës*, Aktgjykim i 23 qershorit 1993, paragrafi 63; *McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 24 shkurtit 1995, paragrafi 80; *Vermeulen kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 20 shkurtit 1996, paragrafi 33; *Lobo Machado kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 20 shkurtit 1996, paragrafi 31; *Kress kundër Francës*, Aktgjykim i 7 korrikut 2001, paragrafi 74). Kjo kërkesë mund të zbatohet gjithashtu para një Gjykate Kushtetuese (shih rastin e GjEDNj-së: *Milatová dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim

i 21 qershorit 2005, paragrafët 63-66; *Gaspari kundër Sllovenisë*, Aktgjykim i 21 korrikut 2009, paragrafi 53).

90. Shembuj të mosrespektimit të parimit të barazisë së armëve, përkatësisht GjEDNj-ja kishte gjetur që ky parim ishte shkelur në rastet kur njëra nga palët ishte vendosur në një disavantazh të qartë: ankesa e një pale nuk iu dha palës tjetër, e cila për këtë arsye nuk kishte asnjë mundësi të përgjigjej (shih rastin e GjEDNj-së: *Beer kundër Austrisë*, Aktgjykim i 6 shkurtit 2001, paragrafi 19).

b. Zbatimi i këtyre parimeve në rastin e parashtruesit të kërkesës

91. Gjykata, fillimisht rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës, Komunës së Gjakovës, për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit si rezultat i mosdërgimit të propozimit për përsëritje të procedurës të parashtruar nga pala e interesuar, Afrim Radoniqi, si dhe mos dhënies së mundësisë për të paraqitur përgjigje në këtë kërkesë.

92. Në lidhje me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se kishte kërkuar nga Gjykata Supreme informatën se a e kishte njoftuar e njëjta parashtruesin e kërkesës, Komunën e Gjakovës, lidhur me propozimin për përsëritje të procedurës? Si dhe cili ishte detyrimi ligjor për një lajmërim të tillë?

93. Gjykata Supreme në përgjigjen e ofruar Gjykatës të 2 korrikut 2021, theksoi si në vijim:

> *"Sa i përket informatave të kërkuara konstatuam se paditësi iu ka drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për rishikimin e aktvendimit [ARJ-UZVP.nr.15/2020] me 20.10. 2020, për shkaqe sipas paditësit se Gjykata Supreme në mënyrë të gabuar ka proceduar dhe ka rishqyrtuar pikën II të dispozitivit të aktvendimit [AA.UZH.nr.505/2018] dt.05.11.2019 të Gjykatës së Apelit.*
>
> *Në shkresat e lëndës Komuna e Gjakovës nuk ka qenë palë në procedurë dhe nuk ka evidencë se të njëjtës iu ka dërguar kjo kërkesë."*

94. Në vijim Gjykata vë theksin tek (i) paragrafi 3 i nenit 60; dhe (ii) paragrafi 1 i nenit 61 të Ligjit për Konfliktet Administrative që përcaktojnë:

Neni 60

[...]

3. Nëse gjykata nuk e hedh poshtë kërkesën sipas paragrafit 2. të këtij neni, do t'ia dërgojë palës së kundërt dhe personave të interesuar dhe do t'i ftojë që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh t'i përgjigjen kërkesës.

[...]

Neni 61

1. Pas skadimit të afatit për përgjigje në kërkesë për rishikim, gjykata vendos me aktgjykim mbi kërkesën për rishikim.

95. Së pari, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në përgjigjen e dhënë me 2 korrik 2021, deklaron se nuk ia ka dorëzuar kërkesën për përsëritje të procedurës Komunës së Gjakovës. Gjithashtu, Gjykata Supreme deklaron se Komuna e Gjakovës nuk ishte palë në procedurë. Përkundër përgjigjes së dhënë, Gjykata vëren se ekzistonte një detyrim për dërgimin e kërkesës për përsëritje të procedurës edhe palës së kundërt dhe personave të interesuar, që derivonte nga dispozitat e lartcekura të Ligjit për Konfliktet Administrative.

96. Gjykata rikujton se GjEDNj dhe Gjykata në praktikat e tyre gjyqësore kanë theksuar që parimi i "barazisë së armëve" kërkon "*një baraspeshë të drejtë ndërmjet palëve*", ku secilës palë duhet dhënë mundësia e arsyeshme për të paraqitur rastin e vet në kushte që nuk e vënë atë në pozitë konsiderueshëm të pabarabartë *vis-à-vis* palës kundërshtare. Në këtë kuptim, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ka dështuar të garantojë zbatimin e parimit të barazisë se armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural, sepse parashtruesi i kërkesës është vënë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis-à-vis* paditësit, palës së interesuar, Afrim Radoniqi, duke u privuar nga mundësia për të pasur një ballafaqim real dhe përmbajtësor me argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga pala e interesuar, si palë kundërshtare në procedurë.

97. E drejta në procedurë kontradiktore në parim nënkupton mundësinë që palët në procedurë penale ose kontestimore të jenë në dijeni dhe të

komentojnë për të gjitha provat e administruara ose për parashtresat e paraqitura, madje edhe nga një anëtar i pavarur i shërbimit juridik nacional, ashtu që të kenë ndikim në vendimin gjyqësor. Pra, Gjykata konsideron se detyrimi i njoftimit të palës kundërshtare, nga gjykatat, për ushtrimin e mjeteve juridike kundër tyre, nuk është qëllim në vetvete. Ky detyrim është hap i domosdoshëm procedural për t'ua mundësuar palëve që të trajtohen në mënyrë të barabartë, të kenë mundësi të kundërshtojnë pretendimet dhe argumentet e palës kundërshtare dhe të paraqesin rastin e tyre në mënyrë efektive (shih rastin e Gjykatës KI193/19, me parashtrues *Salih Mekaj*, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2020, paragrafi 59).

98. Prandaj, Gjykata konsideron se ky mosdërgim i kërkesës së lartcekur dhe mungesa e ndonjë mundësie për parashtruesin e kërkesës, Komunën e Gjakovës, për t'u përgjigjur në kërkesën për përsëritje të procedurës të palës së interesuar, Afrim Radoniqi, përbën një shkelje të parimeve të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve siç garantohet nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 i KEDNj-së (shih, *mutandi mutandis,* rastin e Gjykatës KI209/19, me parashtrues *Memli Krasniqi*, Aktgjykim i 26 nëntorit 2020, paragrafi 57).

99. Gjykata e përsërit se shembuj të mosrespektimit të parimit të barazisë së armëve, respektivisht GjEDNj ka konstatuar se ky parim është cenuar në rastet kur njëra nga palët është vënë në pozitë qartazi të pafavorshme: ankesa e njërës palë nuk i është dhënë palës tjetër, e cila kësisoj nuk ka pasur mundësinë të përgjigjet (shih, rastin ESLJP-a: *Beer kundër Austrisë*, Aktgjykim i 6 shkurtit 2001, paragrafi 19).

100. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konsideron se ky lëshim i Gjykatës Supreme përbën një të metë procedurale të pakapërcyeshme, sepse parashtruesi i kërkesës është privuar nga e drejta e tij për një proces të rregullt gjyqësor, që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së.

101. Prandaj, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNj-së.

102. Tutje, Gjykata qartëson se kur ajo shqyrton procedurën në tërësi, në ndërlidhje me nenin 31 të Kushtetutës, para së gjithash ajo vlerëson: 1) nëse parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesë argumente dhe dëshmi që ai i konsideron relevante për rastin e tij; 2) nëse atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare dhe nëse të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin të rëndësishme për

zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; 3) nëse arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; 4) nëse në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih rastet e Gjykatës: KI193/19, me parashtrues *Salih Mekaj*, cituar më lartë, paragrafi 62; KI118/17, parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GjEDNj, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

103. Duke pasur parasysh që Gjykata ka gjetur shkelje të parimeve të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në kuadër të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNj-së, nuk e sheh të nevojshme të shqyrtojë ndaras pretendimet për sa i përket parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, lidhur me arsyetimin për lejimin për propozimin e për përsëritje të procedurës të paditësit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 shtator 2021, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm, Aktgjykimin [UPP-APP.nr. 1/2020] e 28 tetorit 2020, të Gjykatës Supreme të Kosovës;

IV. TË KTHEJË Aktgjykimin [UPP-APP.nr. 1/2020] e 28 tetorit 2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës, për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme të Kosovës që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më 9 mars 2022, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;

VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Radomir Laban	Gresa Caka-Nimani

KO61/21, parashtrues, Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 08/V-005, të 22 marsit 2021, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës

KO61/21, Aktgjykim i miratuar më 24 shtator 2021

Fjalët kyç: Kërkesë institucionale, caktimi i ministrave, komunitet jo shumicë, miratim/konsultime

Në titullin – **PËRFUNDIME** – të këtij Aktgjykimi, Gjykata përmblodhi esencën e rastit si në vijim:

Në kërkesën KO 61/21, objekt i çështjes së shqyrtimit ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës [nr. 08/V-005], të 22 marsit 2021, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës pretenduan që Vendimi për zgjedhjen e Qeverisë nuk është në përputhje me nenin 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës, sepse Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal nuk është zgjedhur pas konsultimit të shumicës së deputetëve të cilët përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvendin e Kosovës.

Çështja kryesore që ngërthen ky rast ndërlidhet me mënyrën e caktimit të ministrave që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Qeveri. Para Gjykatës, nuk ishte kontestuese mënyra e caktimit të një (1) ministri që caktohet detyrimisht nga komuniteti Serb; ose një (1) ministri që caktohet detyrimisht nga komunitetet e tjera jo shumicë, por caktimi i ministrit të "tretë" në Qeveri nga komunitetet jo shumicë, që është detyrim kushtetues në rast se Qeveria përbëhet nga më tepër se dymbëdhjetë (12) ministra. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës pretenduan se për caktimin e ministrit të "tretë" në Qeveri është i nevojshëm konsultimi/miratimi nga shumica e të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvend, përkatësisht nga të paktën njëmbëdhjetë (11) nga njëzet (20) deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë.

Gjykata Kushtetuese theksoi se, për qëllime të kushtetutshmërisë së përbërjes së Qeverisë, bazuar në nenin 96 të Kushtetutës, në Qeveri duhet të jenë së paku një (1) ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera jo shumicë. Mënyra e zgjedhjes së këtyre ministrave dallon varësisht nëse kandidati i propozuar për ministër është deputet i Kuvendit ose jo. Për caktimin e një kandidati për Ministër nga radhët e deputetëve të Kuvendit, është i nevojshëm konsultimi me partitë, koalicionet

ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Ndërsa, për caktimin e një kandidati për ministër jashtë radhëve të deputetëve të Kuvendit, është i nevojshëm miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë. Gjykata Kushtetuese gjithashtu theksoi se, Kushtetuta përcakton që në rast se përbërja e një Qeverie ka më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, Qeveria duhet të ketë edhe një ministër të tretë, "i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë". Gjykata tutje theksoi se, për sa i përket ministrit të tretë, Kushtetuta i mundëson diskrecion mandatarit për Kryeministër përkitazi me radhët e komuniteteve përkatëse, nga të cilët mund të zgjidhet një ministër i tretë, duke mos përcaktuar detyrimisht që ky ministër duhet të propozohet/miratohet nga deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb ose nga deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë, por duke kërkuar që të ndiqet procedura e njëjtë përkatësisht konsultimi/miratimi i "komunitetit në fjalë", varësisht nëse kandidati përkatës është deputet i Kuvendit ose jo.

Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata theksoi se ministri i "tretë" nga komunitetet jo shumicë, përkatësisht Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, ishte deputet i Kuvendit i zgjedhur në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, i deklaruar se përfaqëson një nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend në kuptim të nenit 64 [Struktura e Kuvendit] të Kushtetutës dhe i cili është propozuar për këtë pozitë në konsultim me deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend. Duke marrë parasysh që kandidati përkatës ishte deputet i zgjedhur i Kuvendit, miratimi formal nga komuniteti në fjalë nuk është detyrim kushtetues, ndërsa para Gjykatës nuk kishte asnjë pretendim që deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë nuk ishin konsultuar në propozimin e këtij kandidati për ministër, përkundër faktit që Gjykata u kishte mundësuar që të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën e dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës.

Gjykata përfundimisht sqaroi që bazuar në nenin 96 të Kushtetutës, i detyrueshëm është konsultimi me ose miratimi i deputetëve që përfaqësojnë "komunitetin në fjalë", përkatësisht deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb ose që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë, varësisht nëse kandidati përkatës është deputet i Kuvendit ose jo, dhe jo shumica e të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë. Në rrethanat e rastit konkret, kandidati i propozuar për ministër ishte deputet i Kuvendit dhe për pasojë miratimi formal i tij nuk ishte detyrim kushtetues, ndërsa para Gjykatës nuk kishte asnjë pretendim që detyrimi për konsultimin e "komunitetit në fjalë" nuk ishte shteruar. Prandaj, Gjykata konstatoi që, Vendimi i kontestuar i Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë nuk është nxjerrë në kundërshtim me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO61/21

Parashtrues

Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 08/V-005, të 22 marsit 2021, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Slavko Simić, Zoran Mojsilović, Miljana Nikolić, Ivan Todosijević, Verica Ćeranić, Branislav Nikolić, Jasmina Dedić, Ljubinko Karadžić, Miloš Perović, Adem Hodža dhe Igor Simić (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi).

2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar deputetin e Kuvendit, Igor Simić, që t'i përfaqësojë ata në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

Akti i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit nr. 08/V-005, të 22 marsit 2021, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: vendimi i kontestuar).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet se nuk është në pajtueshmëri me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

5. Parashtruesit e kërkesës më tej kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme *"me të cilën do ta vendoste në gjendje qetësie pozitën e ministrit i cili u emërua Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal - Elbert Krasniqi sepse nuk e ka mbështetjen e (11) njëmbëdhjetë deputetëve që përbën shumicën e (20) njëzet deputetëve të cilët përfaqësojnë komunitetet jo shumicë"*.

6. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkojnë që Gjykata *"në pajtim me nenin 24 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe nenin 42 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, të mbajë një dëgjim publik në të cilin do të ftonte të gjithë deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë (komuniteti Serb jo shumicë prej (10) dhjetë deputetëve dhe të komuniteteve tjera jo shumicë (10) dhjetë deputetë) [...]"*.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, nenet 27 [Masat e përkohshme], 42 [Saktësimi i kërkesës] dhe 43 [Afatet], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullat 56 [Kërkesa për masë të përkohshme], 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit], të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 29 mars 2021, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesën e tyre në Gjykatë.

9. Në të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi, gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).

10. Më 30 mars 2021, parashtruesit e kërkesës u njoftuan për regjistrimin e kërkesës.

11. Po të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës z. Glauk Konjufca (në tekstin e mëtejmë: U.d. Presidenti), Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Albin Kurti (në tekstin e mëtejmë: Kryeministri) dhe Avokatit të Popullit, me udhëzimin që t'i dorëzojnë Gjykatës komentet, nëse kanë, deri më 14 prill 2021. Kërkesa po ashtu iu komunikua edhe Kryetarit të Kuvendit z. Glauk Konjufca, të cilit iu kërkua që të njoftojë deputetët e Kuvendit se mund të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, nëse kanë, deri më 14 prill 2021.

12. Më 30 mars 2021, Gjykata po ashtu kërkoi nga Sekretariati i Kuvendit që deri me datë 14 prill 2021, t'ia dorëzojë Gjykatës të gjitha dokumentet relevante për vendimin e kontestuar.

13. Më 2 prill 2021, Sekretariati i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentet relevante lidhur me vendimin e kontestuar, dhe atë:

- Dekretin nr. 61/2021, të datës 22 marsit, të u.d Presidentit;
- Kërkesën e 52 deputetëve të Kuvendit për thirrjen e Seancës së jashtëzakonshme për votimin e Qeverisë: Do-08/13, të 22 marsit 2021;
- Ftesat për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme të Kuvendit të 22 marsit 2021;
- Vendimin e Kuvendit nr. 08-V -005, të 22 marsit 2021; dhe,
- Transkriptin e Mbledhjes (Seancës) së Jashtëzakonshme të Kuvendit, të 22 marsit 2021.

14. Më 14 prill 2021, Kryeministri në emër të Qeverisë dorëzoi komente lidhur me kërkesën.

15. Më 20 prill 2021, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës, Presidenten znj. Vjosa Osmani, Kryetarin e Kuvendit, dhe Avokatin e Popullit, lidhur me komentet e Kryeministrit dhe dokumentet e pranuara nga Sekretariati i Kuvendit. Gjykata po ashtu njoftoi Kryeministrin lidhur me dokumentet e pranuara nga Sekretariati i Kuvendit.

16. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21 u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

17. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

18. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KSH61/21, emëroi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci si anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.

19. Më 24 qershor 2021, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë shkresën *"Plotësim i kërkesës KO 61-21"*. Në këtë shkresë, parashtruesit e kërkesës theksuan se "*Me këtë parashtresë dëshirojmë të plotësojmë kërkesën dhe të njoftojmë Gjykatën Kushtetuese se përveç shkeljeve të cilat i kemi theksuar në kërkesën tonë të parë të regjistruar në Gjykatë me numër KO 61-21, tashmë 90 ditë ekziston edhe një shkelje e vazhdueshme e nenit 96 paragrafi 4, pasi që në Qeveri nuk është emëruar asnjë zëvendësministër para komunitetit Serb, siç parashihet në nenin 96 paragrafi 4 [të Kushtetutës]"*.

20. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

21. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin KSH61/21, duke e zëvendësuar Kryetaren paraprake, Arta Rama-Hajrizi, në rolin e saj si kryesuese në Kolegjin shqyrtues.

22. Më 28 korrik 2021, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe vendosi që rasti të shqyrtohet sërish në një seancë të ardhshme.

Gjykata gjithashtu vendosi se nuk mund të shqyrtojë pretendimet e reja në kuadër të kërkesës KO61/21, e cila tanimë është duke u shqyrtuar nga ajo. Rrjedhimisht, më 3 gusht 2021, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës se në përputhje me rregullat 33 (Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit), 34 (Përmirësimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 38 (Kolegjet shqyrtuese) të Rregullores së punës, pretendimet e paraqitura në shkresën për *"plotësimin e kërkesës KO 61-21"* të dorëzuara me 24 qershor 2021, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata përmes kërkesës K061/21.

23. Më 22 shtator 2021, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

24. Më 24 shtator 2021, Gjykata vendosi (i) njëzëri, se kërkesa është e pranueshme; (ii) me shumicë votash, se vendimi i kontestuar është në pajtueshmëri me Kushtetutën; (iii) njëzëri, refuzoi kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme; dhe (iv) me shumicë votash, refuzoi kërkesën për mbajtjen e seancës dëgjimore.

Përmbledhja e fakteve

25. Më 6 janar 2021, U.d Presidentja znj. Vjosa Osmani, nxori Vendimin nr.02/2021, për caktimin dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend, të cilat u caktuan për 14 shkurt 2021.

26. Më 14 shkurt 2021, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvend.

27. Më 13 mars 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: KQZ) certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend të 14 shkurtit 2021, përmes Vendimit nr.950/2021, sipas listës vijuese të rezultateve të zgjedhjeve:

a) Lëvizja VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejmë LVV), 58 deputetë;
b) Partia Demokratike e Kosovës - PDK, 19 deputetë;
c) Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK, 15 deputetë;
d) Srpska Lista, 10 deputetë;
e) Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës -AAK, 8 deputetë;
f) Kosova Demokratik Turk Partisi - KDTP, 2 deputetë;
g) Koalicija “Vakat”, 1 deputet;
h) Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, 1 deputet;
i) Romani Iniciativa – RI, 1 deputet;
j) Nova Demokratska Stranka - NDS, 1 deputet;
k) Socialdemokratska Unija –SDU, 1 deputet;
l) Jedinstvena Goranska Partija, 1 deputet;

m) Partia e Ashkalinjëve për Integrim, 1 deputet;
n) Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës - LPRK, 1 deputet.

28. Më 16 mars 2021, në vazhdën e takimeve me partitë politike që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvend, u mbajt një takim në mes të përfaqësuesve të LVV-së dhe atyre të Listës Serbe.

29. Më 21 mars 2021, z. Albin Kurti, në cilësinë e tij si Kryetar i LVV-së, i kishte dërguar një letër z.Goran Rakić, në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i Listës Serbe, duke theksuar se: *"[...] në pajtim me nenin 96, par. 3 dhe 4 [të Kushtetutës], në lidhje me nenin 92 par. 1 dhe 2, në cilësinë e Kryetarit të partisë fituese dhe Kryeministrit të ardhshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 95 par. 3 dhe 4 [të Kushtetutës], ju ftoj juve- Listën Serbe, të propozoni emrat e tre deputetëve të partisë suaj, nga të cilët unë do të zgjedh një Ministër të Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit [...]".*

30. Po atë ditë, pra më 21 mars 2021, z.Goran Rakić, në cilësinë e tij si Kryetar i Listës Serbe, i dërgoi një shkresë z. Albin Kurti në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i LVV-së, në përgjigje të shkresës së lartcekur, duke theksuar si në vijim: "[...] *në rast se propozoni një Qeveri me 12 ministra, ne do të japim emrin e një ministri.*

Në rast se ju propozoni një Qeveri me më shumë se 12 ministri, dua të ju informoj se në pajtim me nenin 96, paragrafët 3, 4 dhe 5, ju jeni të obliguar të caktoni 3 ministri në administrim të komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

Në lidhje me këtë, dëshiroj të ju informoj se grupi parlamentar i Listës Serbe në legjislaturën e re do të ketë 11 deputetë (10 nga Lista Serbe dhe 1 nga Partia Unike Gorane), që përfaqëson shumicën e numrit të përgjithshëm prej (20) deputetëve në Kuvendin e Kosovës, të cilët përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në pajtim me nenin 96, paragrafët 3, 4 dhe 5.

Pra, nëse qeveria e ardhshme ka më shumë se 12 ministri, nesër ne do t'ju sigurojmë 2 emra për ministra që nuk janë nga radhët e deputetëve, por në pajtim me Kushtetutën kanë mbështetjen e 11 deputetëve që mbajnë vende të destinuara për komunitetet jo shumicë.[...]."

31. Më 22 mars 2021, u mbajt mbledhja konstituive e Kuvendit, me tri pika të rendit të ditës:

4. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve;
5. Dhënia e betimit të deputetëve;
6. Zgjedhja e Kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit.

32. Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, në të njëjtën ditë paraqiti Raportin para Kuvendit. Pas kësaj, deputetët dhanë betimin si dhe me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve u konstituua Kuvendi.

33. Po atë ditë, U.d Presidenti nxori Dekretin Nr.61/2021 me të cilin *"Z. Albin Kurti i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës"*.

34. Më 22 mars 2021, 52 (pesëdhjetë e dy) deputetë të Kuvendit paraqitën kërkesë për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme për votimin e Qeverisë.

35. Po atë ditë, pra më 22 mars 2021, z. Albin Kurti, në cilësinë e tij si Kryetar i LVV-së dhe si Mandatar për Kryeministër, i kishte dërguar një letër z.Goran Rakić, në cilësinë e Kryetarit të Listës Serbe, duke theksuar, mes tjerash, si në vijim *"në cilësinë e kryetarit të partisë fituese dhe mandatarit për Kryeministër për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 95, paragrafët 3 dhe 4, ju ftoj juve - Listën Serbe të propozoni emrat e tre deputetëve të partisë tuaj, nga të cilët unë do të zgjedh një për Ministër të Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit [...]."*

36. Në të njëjtën ditë, z.Goran Rakić, në cilësinë e tij si Kryetar i Listës Serbe, i dërgoi një shkresë z. Albin Kurti në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i LVV-së dhe Mandatar për formimin e Qeverisë, duke theksuar si në vijim: *"[...] Duke pasur parasysh që ju propozoni një Qeveri me më shumë se 12 ministri, në pajtim me nenin 96 par. 3, 4 dhe 5 ju jeni të obligua të ndani tri ministri në administrim të komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Në lidhje me këtë, ne dëshirojmë t'ju informojmë se 11 deputetë (10 nga Lista Serbe dhe një nga Partia Unike Gorane) që përfaqëson shumicën e numrit të përgjithshëm (20) deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvendin e Kosovës, në pajtim me nenin 96, paragrafët 3, 4 dhe 5 të Kushtetutës së Kosovës ju japin emrin e kandidatit për ministrin e tretë.*
Ai është:
Dalibor Jevtic [...]".

37. Po atë ditë, pra më 22 mars 2021, Kuvendi mbajti mbledhjen e jashtëzakonshme të thirrur nga 52 deputetë të Kuvendit, me rend të ditës, Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me ç'rast i mandatuari për Kryeministër z. Albani Kurti, paraqiti përbërjen e Qeverisë, si në vijim:

1. Albin Kurti, Kryeministër;
2. Besnik Bislimi, Zëvendëskryeministër i parë për integrime evropiane, zhvillim dhe dialog;
3. Donika Gërvalla, Zëvendëskryeministre e dytë dhe Ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
4. Emilija Redžepi, Zëvendëskryeministre e tretë për çështje të pakicave dhe të drejtat e njeriut (përfaqësuese nga komunitetet tjera jo shumicë në Kuvend);
5. Hekuran Murati, Ministër i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
6. Albulena Haxhiu, Ministre e Ministrisë së Drejtësisë;
7. Armend Mehaj, Ministër i Ministrisë së Mbrojtjes;
8. Xhelal Sveçla, Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike;
9. Arben Vitia, Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë;
10. Arbërie Nagavci, ministre e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
11. Hajrulla Çeko, Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
12. Elbert Krasniqi, ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (përfaqësues nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend);
13. Liburn Aliu, Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
14. Faton Peci, Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
15. Rozeta Hajdari, Ministre e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
16. Artane Rizvanolli, Ministre e Ministrisë së Ekonomisë;
17. Goran Rakić, Ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (i votuar nga deputetët jo shumicë që përfaqësojnë komunitetin Serb në Kuvend);
18. Fikrim Damka, Ministër i Ministrisë për Zhvillim Rajonal (përfaqësues nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend).

38. Ashtu si u theksua më lart, lidhur me z.Goran Rakić, i propozuar për pozitën e ministrit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim nga përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kuvendit e Kosovës, pasi i njëjti nuk ishte deputet i Kuvendit, konform paragrafit 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve], u votua ndaras nga

deputetët e komuniteti Serb, me ç'rast ai propozim mori 10 nga 10 votat e deputetëve që përfaqësojnë komunitetin Serb në Kuvendin e Kosovës.

39. Po atë ditë, pra më 22 mars 2021, përmes vendimit të kontestuar, nr. 08/V-005, Kuvendi zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës, me 67 vota "për", 30 "kundër" dhe asnjë "abstenim", sipas përbërjes së propozuar të cekur më lart.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

40. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimi i kontestuar nuk është në pajtim me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës.

41. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se neni 96 i Kushtetutës parasheh që në Qeveri duhet të jetë së paku *"një (1) ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) ministër nga ndonjë komunitet tjetër jo shumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë."*

42. Lidhur me këtë ata shtojnë se *"sipas nenit 96 par. 3 rezervimi i vendit për të paktën (2) dy ministra të komuniteteve jo shumicë por nuk përjashton mundësinë që Qeveria të ketë më shumë se dy ministra të tillë. Megjithatë, sipas detyrimeve sipas këtij neni, të paktën (2) dy ministra nga komunitetet jo shumicë në Kosovë duhet të jenë pjesë e Qeverisë. Përfaqësimi i rezervuar i komuniteteve jo shumicë në Qeveri përbën të ashtuquajturin parim „të qeverisë së gjerë" në kuptim të multietnicitetit, dhe është një kusht kryesor i demokracisë konsociacionale („consotiational democracy"). Ky model i strukturës së Qeverisë mundëson që karakteri i garantuar multietnik i shtetit shprehet jo vetëm për përfaqësim të rezervuar në qeveri, por edhe sepse ministrat që rezultojnë nga ky nen i Kushtetutës përfaqësojnë zërin e komuniteteve të tyre në procesin e krijimit të politikave qeveritare."* Lidhur me këtë ata i referohen Komentarit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës *Hasani, Enver dhe Čukalović, Ivan, (2013)* GIZ, Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Komentari i Kushtetutës).

43. Duke iu referuar sërish Komentarit të Kushtetutës ata shtojnë se *"emërimi i ministrave dhe zëvendësministrave nga komunitetet jo shumicë në pajtim me nenin 96.4 do të bëhet pas konsultimet me partitë, koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë. Nëse emërohen kandidatët nga jashtë strukturës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për emërimin e tyre kërkohen*

votat e shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët janë anëtarë të partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur të cilët kanë deklaruar se do të përfaqësojnë komunitetet në fjalë. [...] Nga pikëpamja ligjore, termi "konsultim" i përdorur në këtë nen i referohet procedurës kur partia/koalicioni që përfaqëson komunitetin në fjalë në Kuvendin e Kosovës jep kandidaturën e saj për përbërjen e Qeverisë që vendos kandidatin për Kryeministër. Pranimi i kandidatit të propozuar nga partia/koalicioni që përfaqëson komunitetin përkatës jo shumicë është i detyruar brenda kuptimit të nenit 96.5, në të kundërtën, do të konsiderohej që nuk është përmbushur detyrimi për konsultim të plotë me partinë/koalicionin në pajtim me këtë nen. Kjo do të thotë që ky nen e imponon një lloj koalicioni parlamentar, madje edhe në mënyrë të nënkuptuar, midis partive/koalicioneve që synon të formojë Qeverinë dhe deputetët e komuniteteve jo shumicë, pasi që pranimi i kandidatit të tyre në përbërjen e qeverisë është një detyrim sipas nenit në fjalë. Ky lloj koalicioni, edhe në mënyrë implicite, rezulton në një koalicion parlamentar multietnik, e cila është mënyra e vetme për të zbatuar dispozitat që dalin nga ky nen [neni 96 i Kushtetutës]".

44. Lidhur me ministrinë e tretë nga radhët e komuniteteve jo shumicë, parashtruesit e kërkesës theksojnë së *"Kushtetuta nuk përcakton qartë këtu nëse ky ministër vjen nga radhët e komuniteteve jo shumicë serbe apo nga komunitetet e tjera jo shumicë. Por neni 96 paragrafi 5 përcakton që ministrat që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë duhet të emërohen "pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë"*.

45. Andaj, ata shtojnë se *"[...] është e qartë se as këtu dhe as në rastet e mëparshme të përfaqësimit të pakicave Kushtetuta nuk e la mundësinë që mandatari ose Kryeministri të kenë lirinë e zgjedhjes, por me Kushtetutë kërkohen konsultime për të siguruar një përfaqësim reprezentues të komuniteteve jo shumicë në konsultim me partitë, koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë."* Andaj, ata shtrojnë pyetjen *"se si të vihet deri te një përfaqësim reprezentues të komuniteteve jo shumicë në rastin kur Kushtetuta nuk përcakton qartë se nga cili komunitet vjen ministri i tretë si në dy rastet e mëparshme"*.

46. Ata mbajnë qëndrimin se *"[...] nëse ministri që përfaqëson komunitetin Serb emërohet nga shumica prej (10) dhjetë deputetëve që përfaqësojnë komunitetin Serb, dhe nëse ministri nga komunitetet e tjera jo shumicë emërohet me shumicën e (10) dhjetë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet tjera jo shumicë, atëherë është plotësisht*

logjike që ministri i (3) tretë i emëruar nga komunitetet jo shumicë të emërohet nga një shumicë prej (20) njëzet deputetëve të cilët, në pajtim me nenin 64 të Kushtetutës, përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë (komuniteti Serb jo shumicë (10) deputetë dhe komunitetet e tjera jo shumicë prej (10) dhjetë deputetëve). [...] Që do të thotë se Kryeministri është i detyruar të mbajë konsultime dhe si ministër i tretë që përfaqëson komunitetet jo shumicë në Kosovë emëron një përfaqësues të komuniteteve jo shumicë (qoftë nga komuniteti Serb jo shumicë ose nga komunitetet e tjera jo shumicë) në Kosovë i cili arrin të sigurojë mbështetjen e shumicës prej (20) njëzet deputetëve që përbëjnë shumicën e komuniteteve, përkatësisht (11) njëmbëdhjetë nga gjithsej (20) njëzet deputetë të cilët, në pajtim me nenin 64 të Kushtetutës, përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë (komuniteti Serb jo shumicë (10) dhjetë deputetë dhe komunitetet tjera jo - shumicë (10) dhjetë deputetë)".

47. Duke u bazuar në argumentet e lartcekura, parashtruesit e kërkesës shtojnë se "*ministri i tretë është Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal – Elbert Krasniqi i cili u emërua pa konsultim si përfaqësues i komunitetit jo shumicë në kundërshtim me nenin 96 të Kushtetutës sepse nuk siguroi mbështetjen e (11) njëmbëdhjetë deputetëve nga gjithsej (20) njëzet deputetë të cilët, në pajtim me nenin 64 të Kushtetutës, përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë (komuniteti Serb jo shumicë (10) dhjetë deputetë dhe komunitetet tjera jo shumicë (10) dhjetë deputetë)*. Andaj, në rastin konkret ata konsiderojnë se *"të drejtat e komuniteteve jo shumicë në përgjithësi dhe të komunitetit Serb në veçanti janë margjinalizuar dhe në mënyrën më të vrazhdë anashkalon shkronjën dhe frymën e Kushtetutës duke caktuar Ministër të Administratës së Vetëqeverisjes Lokale - Elbert Krasniqin i cili në legjislaturën e fundit madje nuk ishte pjesë e grupit parlamentar të komuniteteve jo shumicë por ishte pjesë e grupit parlamentar të subjektit politik të Lëvizjes Vetëvendosje"*.

48. Andaj, ata theksojnë se *"[k]onsiderojmë se Kryeministri është dashur, në pajtim me nenin 96, të thërrasë konsultime me të gjitha komunitetet jo shumicë dhe të emërojë si ministër të tretë në përputhje me nenin 96 paragrafi 3 atë përfaqësues të komuniteteve jo shumicë që arrin të sigurojë (11) njëmbëdhjetë vota të deputetëve, përkatësisht, shumicën e votave nga (20) njëzet vota në këshillin e komuniteteve, i cili pikërisht për këtë edhe ekziston që të shprehë pikëpamjet e komuniteteve jo shumicë"*.

49. Duke bërë krahasime me pozitat e tjera të komuniteteve jo shumicë në Kuvend apo që emërohen nga Kuvendi, ata theksojnë së *"[...]*

pothuajse të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë emërohen në këtë mënyrë, për shembull (nënkryetari i Kuvendit para komunitetit Serb), është logjike që me 10 vota serbe ai kurrë nuk mund të marrë 61 votë sa i duhet të emërohet nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, por kjo nuk do të thotë që Kryetari i Kuvendit mund t'i imponojë komunitetit Serb se cili nga deputetët Serbë do të jetë nënkryetar i Kuvendit. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen në mënyrë të ngjashme, ku për dy gjyqtarë kërkohet së pari votim në këshillin e komunitetit dhe vetëm pasi të marrin miratimin nga deputetët e komunitetit jo shumicë do të votohen në kuvend në legjislaturën e plotë. [...] Me norma të tilla, kushtetutbërësi dëshironte të mbronte të drejtat e komuniteteve jo shumicë, në mënyrë që shumica të mos i mbivotonte dhe margjinalizonte, që pikërisht është bërë gjatë zgjedhjes së qeverisë".

50. Andaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë që Gjykata: *i)* të shpallë kërkesën të pranueshme; *ii)* të konstatojë që vendimi i kontestuar nuk është në pajtueshmëri me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës; si dhe *iii)* të urdhërojë Kryeministrin që në pajtim me nenin 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] i Kushtetutës, të kryejë riorganizimin e Qeverisë dhe të emërojë si ministër të tretë nga komunitetet jo shumicë një person që i përket komuniteteve jo shumicë të propozuar dhe mbështetur nga një shumicë e thjeshtë prej (11) njëmbëdhjetë deputetësh nga gjithsej (20) njëzet deputetë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvend.

Kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme

51. Parashtruesit e kërkesës lidhur me kërkesën për masë të përkohshme, arsyetojnë se janë plotësuar kushtet e parapara në paragrafin (4) të rregullit 57 të Rregullores së punës për nxjerrjen e masës së përkohshme, pasi në rastin konkret kemi një *"rast prima facie për meritat e kërkesës" sepse rasti është paraqitur nga (11) njëmbëdhjetë deputetë brenda (8) tetë ditësh dhe në përputhje me nenin 113 paragrafi 5, rasti është qartazi i pranueshëm në merita*".

52. Ata shtojnë se *"[...] për sa i përket vetë dëmit të pariparueshëm, është e qartë se kemi një përfaqësim jo-reprezentues të komuniteteve jo shumicë në Kuvendin e Kosovës ku një person përfaqëson komunitetet jo shumicë edhe pse nuk ka mbështetjen e (11) njëmbëdhjetë deputetëve që përbën shumicën e (20) njëzet deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë, me ç'rast shumica në*

komunitetet jo shumicë pëson dëme të paripërueshme sepse ato i përfaqëson një person i paautorizuar i cili nuk është përfaqësues reprezentues i komuniteteve jo shumicë".

53. Gjithashtu, sa i përket kriterit se masa e përkohshme duhet të jetë në interes publik ata arsyetojnë se *"Qeveria e Kosovës aktualisht është në përbërje antikushtetuese sepse në përbërjen e saj ulet një person që nuk ka autoritetin e deputetit të komuniteteve jo shumicë për të përfaqësuar komunitetet jo shumicë. Është në interesin publik që Qeveria të themelohet në përbërje Kushtetuese dhe që Qeveria të punon dhe funksionon në pajtim me Kushtetutën. Për shkak se në këtë moment nuk është ky rasti, është në interesin publik të vendoset një masë e përkohshme me të cilën do ta vendoste në gjendje qetësie pozitën e ministrit i cili u emërua Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal - Elbert Krasniqi sepse nuk e ka mbështetjen e (11) njëmbëdhjetë deputetëve që përbën shumicën e (20) njëzet deputetëve të cilët përfaqësojnë komunitetet jo shumicë".*

Kërkesa për mbajtje të seancës dëgjimore publike

54. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkojnë nga Gjykata mbajtjen e seancës dëgjimore në të cilin kjo e fundit do të ftonte të gjithë deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë që të përcaktojë çështjet në vijim:
- cili përfaqësues i komunitetit Serb ka mbështetjen e shumicës prej 10 (dhjetë) deputetëve që përfaqësojnë komunitetin Serb në mënyrë që të emërohet ministër;
- cili përfaqësues i komuniteteve të tjera jo shumicë ka mbështetjen e shumicës prej (10) dhjetë deputetëve përfaqësojnë komunitete të tjera jo shumicë, në mënyrë që të emërohet ministër;
- cili përfaqësues i të gjitha komuniteteve jo shumicë ka mbështetjen e shumicës ose (11) njëmbëdhjetë nga gjithsej (20) njëzet deputetë për tu emëruar ministër i tretë i komuniteteve jo shumicë nëse Qeveria i ka më tepër se 12 (dymbëdhjetë) ministri;
- të përcaktohet se ministri i tretë para komuniteteve jo shumicë i cili është emëruar Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal - Elbert Krasniqi, i cili është përfaqësues i të gjitha komuniteteve jo shumicë, nuk ka pasur mbështetjen e shumicës së thjeshtë prej (11) njëmbëdhjetë nga gjithsej 20 njëzet deputetë të cilët sipas nenit 64 të Kushtetutës përfaqësojnë komunitetet jo shumicë.

Komentet e Kryeministrit, z. Albin Kurti, të dorëzuara në emër të Qeverisë

55. Kryeministri theksoi se lidhur me kërkesën e paraqitur në Gjykatë, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, kanë ushtruar te drejtën e tyre brenda afatit kushtetues, kanë informuar Gjykatën në lidhje me dispozitat kushtetuese të cilat kanë relevancë për vlerësimin e kushtetutshmërisë se aktit të kontestuar, mirëpo kanë dështuar të ofrojnë prova në lidhje me pretendimet e tyre. Në këtë kontekst, Kryeministri theksoi se "*Qeveria e konsideron të nevojshme që pavarësisht faktit se kërkesa nuk mbështetet në prova dhe nuk arsyeton pretendimin e parashtruesve për pakushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar (qartazi e pabazuar në baza kushtetuese), me qellim që procedura e zgjedhjes dhe emërimit të përfaqësuesve të pakicave në kuadër të Qeverise së Kosovës të konsiderohet e gjykuar nga Gjykata Kushtetuese, Qeveria e konsideron të nevojshme dhe në interes të stabilitetit kushtetues që Gjykata të shpallë të pranueshme kërkesën dhe të vendos në merita të rastit. Sepse një çështje konsiderohet "res judicata" vetëm kur ajo gjykohet përmes një aktgjykimi dhe jo nëse për shkak të mungesës së arsyetimit shpallet e papranueshme proceduralisht*".

56. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se me rastin e zgjedhjes së Qeverisë janë shkelur paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës, Kryeministri thekson se *"parashtruesit kanë keqinterpretuar paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës, sepse kandidati për kryeministër i ka përmbushur detyrimet kushtetuese të parapara me këtë Kushtetutë"*. Pasi Kushtetuta në paragrafin 3 të nenit 96 përcakton se të paktën një (1) ministër nga komuniteti Serb, dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera pakicë, duhet të përfaqësohen në Qeveri, sipas paragrafit 3 të nenit 96 të Kushtetutës, nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet joshumicë në Kosovë. Megjithatë, sipas Kryeministrit "*Kushtetuta nuk përcakton se ministri i tretë i cili përfaqëson komunitetet pakicë domosdoshmërish duhet të jetë përfaqësues i komunitetit Serb. Kushtetuta në këtë rast është e qartë dhe përmban një formulim preciz, i cili nuk lë hapësirë për dykuptimësi*". Lidhur me këtë ai thekson se *"komunitetet jo shumicë" nuk i referohet vetëm komunitetit Serb, por edhe komuniteteve të tjera jo shumicë që jetojnë në Republikën e Kosovës",* duke shtuar se mbi bazën e kësaj ndahen edhe ulëset e garantuara sipas nenit 64.4 të Kushtetutës.

57. Lidhur me këtë, Kryeministri i referohet edhe ligjeve të tjera të cilat përcaktojnë përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në institucione

të tjera shtetërore të cilat i referohen përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në përgjithësi pa përcaktuar kuotat për komunitetin Serb në veçanti. Në këtë aspekt, ai i referohet Ligjit për Avokatin e Popullit, Ligjit për Këshillin e Pavarur të Mediave, dhe Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil. Kryeministri argumenton se ligjet e lartcekura vërtetojnë se në momentin kur nuk specifikohet se nga i cili komunitetet jo shumicë duhet të emërohet një anëtar, ajo nuk nënkupton se me automatizëm këta të emëruar duhet të jenë nga komuniteti Serb. Kjo dëshmohet nga praktika e deritanishme e funksionimit të këtyre institucioneve të pavarura, të cilat anëtarët e tyre i zgjedhin pas votimit të Kuvendit.

58. Kryeministri, lidhur me çështjen e konsultimit me partitë jo shumicë për caktimin e ministrave nga komunitetet jo shumicë thekson se para zgjedhjes së Qeverisë, *"parashtruesit e kërkesës konfirmojnë vet se më datën 21.03.2021 kanë pasur një letërkëmbim me kandidatin për kryeministër, ndërsa me datën 22.03.2021 janë takuar me të, pas mandatimit formal nga u.d. Presidenti. Rrjedhimisht është konsumuar detyrimi kushtetues i konsultimit me ta si përfaqësues të pakicës serbe në Kosove. Po ashtu, ata konfirmojnë se z. Goran Rakic është zgjedhur ministër sipas propozimit të grupit të tyre parlamentar."* Ai shton se *"[s]ikur të ishte shpërfillur propozimi i tyre dhe në vend të z. Rakic të ishte zgjedhur një person tjetër në pozitën e ministrit të garantuar për përfaqësuesit e pakicës serbe, atëherë pretendimi i parashtruesit do të kishte bazë. Mirëpo, të njëjtit nuk e kontestojnë zgjedhjen e z. Rakić".*

59. Në këtë kontekst, ai mban qëndrimin se *"Konsultimi nuk është kategori e cila i jep të drejtën një pakice të caktuar që të diktojë përbërjen dhe ndarjen e ministrive në kuadër të Qeverisë. Mirëpo ai është një proces i cili i jep të drejtën përfaqësuesve të asaj pakice që të njoftojnë kandidatin për Kryeministër së cilët do të jenë përfaqësuesit e asaj pakice në kuadër të përfaqësimit të garantuar me Kushtetutë".*

60. Kryeministri shton se *"Qeveria rithekson se Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet (neni 2.1 i Kushtetutës) dhe shoqëri shumetnike e përberë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike (neni 3.1. i Kushtetutës). Në kuadër të kësaj demokracie, shumica shqiptare ka garantuar përfaqësimin e pakicave në kuadër të institucioneve të saj dhe përmes dispozitave të mësipërme kushtetuese ka garantuar karakterin unitar të rendit kushtetues dhe territorit të Republikës së Kosovës (neni 1 i Kushtetutës)".* Ai më tej thekson se në rastin konkret komunitetet jo

shumicë janë konsultuar dhe në këtë aspekt janë respektuar procedurat kushtetuese për përfaqësimin e tyre në Qeveri.

61. Lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme, Kryeministri thekson se *"Përveç mungesës së arsyeshmërisë për kërkesën për masë të përkohshme, vendosja e masës së përkohshme do të ishte në kundërshtim të plotë me interesin publik. Përmes masës se përkohshme, Qeveria konsideron që do të shkaktohej dëm i paripareushëm, në një kohë kur vendit i duhet Qeveri funksionale në sigurimin e vaksinave për mbrojtje nga pandemia COVID-19 dhe në menaxhimin e përgjithshëm të pandemisë. Për më tepër, vendosja e masës së përkohshme do të ndikonte direkt edhe në mundësitë e Qeverise për të punuar në procesin e rimëkëmbjes ekonomike si dhe do të rrezikonte edhe sigurinë kombëtare. Prandaj, një masë e përkohshme për rastin në fjalë nuk është në interesin publik, si dhe mund të shkaktoj dëm të paripareushëm"*. Kryeministri po ashtu thekson se nuk është e nevojshme as mbajtja e seancës dëgjimore pasi në rastin konkret nuk ka paqartësi në lidhje me çështjen e ligjit dhe faktit, prandaj kërkesa për seancë dëgjimore duhet të refuzohet.

Dispozitat relevante të Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

"Neni 64 [Struktura e Kuvendit]

1. *Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.*

2. *Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon:*

    (1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

(2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

[...]

Neni 95 [Zgjedhja e Qeverisë]

7. *Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.*

8. *Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.*

9. *Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.*

10. *Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.*

11. *Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.*

12. *Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj.*

Neni 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve]

1. *Ministritë dhe organet e tjera ekzekutive themelohen, sipas nevojës, për kryerjen e funksioneve brenda kompetencave të Qeverisë.*

2. *Numri i anëtarëve të Qeverisë përcaktohet me aktin e brendshëm të saj.*

3. *Në Qeveri do të jenë së paku një (1) Ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) Ministër nga ndonjë komunitet tjetër jo shumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë.*

4. *Do të jenë së paku dy (2) zëvendësministra nga komuniteti Serb i Kosovës dhe dy (2) zëvendësministra nga komunitete të tjera jo shumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, Qeveria do të ketë edhe një zëvendësministër të tretë, i cili përfaqëson komunitetin Serb, dhe një (1) tjetër zëvendësministër, i cili përfaqëson një nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë.*

5. *Zgjedhja e këtyre ministrave dhe zëvendësministrave do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse caktohen kandidatë jashtë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për këta ministra e zëvendësministra kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë.*

6. *Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat e Qeverisë mund të zgjidhen nga deputetë të Kuvendit të Kosovës ose nga persona të kualifikuar, që nuk janë deputetë të Kuvendit.*

7. *Papajtueshmëria e anëtarëve të Qeverisë lidhur me funksionet e tyre rregullohet me ligj."*

Pranueshmëria e kërkesës

62. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj e me Rregullore të punës.

63. Në këtë vazhdë, Gjykata i referohet paragrafit 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."*

64. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet nenit 113.5 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur."*

65. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kërkesa është paraqitur nga 11 (njëmbëdhjetë) deputetë të Kuvendit, në pajtueshmëri me nenin 113.5 të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar për të paraqitur këtë kërkesë.

66. Në vijim, Gjykata merr parasysh nenin 42 [Saktësimi i kërkesës], të Ligjit, i cili përcakton se kërkesa e paraqitur sipas nenit 113.5 të Kushtetutës duhet të përmbajë:

> *"1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
> *1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
> *1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti."*

67. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit], të Rregullores së punës, që parasheh:

"[...]

(2) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:

(d) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose të një vendimi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
(e) dispozitat e Kushtetutës ose të aktit tjetër ose legjislacionit relevant për këtë kërkesë; dhe
(f) provat mbi të cilat mbështetet kontesti.

(3) Parashtruesit i bashkëngjisin kërkesës një kopje të ligjit të kontestuar ose vendimit të miratuar nga Kuvendi, regjistrin dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën dhe autorizimin e personit që i përfaqëson ata para Gjykatës."

68. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës: (i) shënuan emrat e deputetëve dhe nënshkrimet e tyre; (ii) paraqitën autorizimin për personin që i përfaqëson ata para Gjykatës; (iii) specifikuan vendimin që kontestojnë, konkretisht Vendimin e Kuvendit nr. 08/V-005, të 22 marsit 2021 për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe dorëzuan kopjen e tij; (iv) iu referuan dispozitave specifike kushtetuese, me të cilat ata pretendojnë se vendimi i kontestuar nuk është në pajtueshmëri; si dhe, (v) paraqitën prova dhe dëshmi për të mbështetur pretendimet e tyre.

69. Andaj, Gjykata konsideron se kriteret e përcaktuara me nenin 42 të Ligjit dhe të specifikuara më tej me rregullin 74 të Rregullores së punës janë plotësuar. Gjithashtu, për sa i përket afatit të përcaktuar për të paraqitur kërkesën, që është 8 (tetë) ditë nga data e miratimit të aktit të kontestuar, Gjykata vëren se vendimi i kontestuar është miratuar më 22 mars 2021, ndërsa kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 29 mars 2021. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa u parashtrua brenda afatit kohor të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.

70. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj e me Rregullore të punës, dhe rrjedhimisht Gjykata e shpallë kërkesën të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

Meritat e kërkesës

Përmbledhja e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe argumenteve të Qeverisë

71. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të 22 marsit 2021 të Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë, për të cilin perëndojnë se është në kundërshtim me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës.

72. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se sipas paragrafit 3 të nenit 96 të Kushtetutës, në Qeveri do të jenë së paku një (1) ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) ministër nga ndonjë komunitet tjetër jo shumicë në Kosovë. Ndërsa, nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: ministri i "tretë"). Në këtë aspekt, ata konsiderojnë se duke pasur parasysh që caktimi i ministrave të komunitetit jo shumicë do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë, emërimi i ministrit të "tretë", duhet të propozohet dhe të ketë mbështetjen nga shumica e njëzet (20) deputetëve të Kuvendit që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë. Andaj, argumentet e tyre për shkelje kushtetuese, parashtruesit e kërkesës i ndërtojnë duke theksuar se Qeveria e zgjedhur përmes vendimit të kontestuar, e që ka më shumë se dymbëdhjetë ministri, ministri i "tretë" i zgjedhur, përkatësisht Ministri Elbert Krasniqi, është zgjedhur në kundërshtim me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës. Kjo sipas tyre pasi që caktimi i tij në Qeveri, nuk është propozuar/miratuar nga shumica e njëzet (20) deputetëve të komuniteteve jo shumicë në Kosovë, ku përfshihen edhe deputetët e komuniteti Serb.

73. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se konform paragrafëve 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës, për caktimin e ministrit të "tretë" në Qeveri, ka qenë i nevojshëm propozimi/miratimi nga shumica e të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë, që në rastin konkret, nënkupton propozimin/miratimin nga të paktën njëmbëdhjetë (11) deputetë të këtyre komuniteteve nga njëzet (20) deputetë, sa janë gjithsej në legjislaturën aktuale të Kuvendit.

74. Lidhur me pretendimet e lartcekura të parashtruesve të kërkesës, Kryeministri, në emër të Qeverisë, thekson se Kushtetuta në

paragrafin 3 të nenit 96 përcakton se të paktën një (1) ministër nga komuniteti Serb, dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosove, duhet të përfaqësohen në Qeveri. Ndërsa, nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë. Lidhur me këtë Kryeministri mban qëndrimin se Kushtetuta nuk përcakton se ministri i "tretë" i cili përfaqëson komunitetet pakicë domosdoshmërisht duhet të jetë përfaqësues i komunitetit Serb. Kjo pasi "komunitetet jo shumicë" nuk i referohet vetëm komunitetit Serb, por edhe komuniteteve të tjera jo shumicë që jetojnë në Republikën e Kosovës. Pasi Kushtetuta nuk specifikon se nga cili komunitetet jo shumicë duhet të caktohet ministri i "tretë", përderisa ai/ajo i përket njërit nga komunitetet jo shumicë në Kosovë, plotësohen kushtet për përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në Qeveri ashtu siç është përcaktuar në nenin 96 të Kushtetutës. Andaj, sipas Kushtetutës nuk kërkohet që ministri i "tretë" të propozohet ose të ketë miratimin e shumicës së të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetin jo shumicë në Kuvend.

75. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës që i referohet kërkesës kushtetuese për "konsultim" me partitë jo shumicë për caktimin e ministrave nga komunitetet jo shumicë, Kryeministri pretendon se procesi i konsultimit nuk nënkupton se kjo i jep të drejtën një pakice të caktuar që të diktojë përbërjen dhe ndarjen e ministrive në kuadër të Qeverisë. Mirëpo, kërkesa për "konsultim" sipas nenit 96 të Kushtetutës është një proces i cili i jep të drejtën përfaqësuesve të asaj pakice që të njoftojnë kandidatin për Kryeministër së kush do të jenë përfaqësuesit e asaj pakice në kuadër të përfaqësimit të garantuar me Kushtetutë.

76. Prandaj, në dritën e këtyre pretendimeve të palëve, Gjykata fillimisht do të vlerësojë kriteret kushtetuese për përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në Qeveri, përkatësisht: *(i)* nëse Kushtetuta e Kosovës, duke përfshirë paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës, parashohin që ministri i "tretë" i Qeverisë që përfaqëson komunitetet jo shumicë në Kosovë (në rast se Qeveria përbëhet nga më tepër se dymbëdhjetë (12) ministri) i takon ndonjë komuniteti të caktuar jo shumicë; *(ii)* të sqarojë nëse ministri i "tretë" duhet të propozohet dhe të marrë mbështetjen formale të shumicës së të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë si dhe obligimet kushtetuese sa i përket konsultimeve me komunitetet jo shumicë për caktimin e ministrit të "tretë"; dhe *(iii)* do të vlerësojë nëse kriteret kushtetuese për caktimin e ministrit të "tretë" në Qeveri janë respektuar në rastin konkret.

(i) Nëse ministri i "tretë" i Qeverisë që përfaqëson komunitetet jo shumicë në Kosovë (në rast se Qeveria përbëhet nga më tepër se dymbëdhjetë (12) ministri) i takon ndonjë komuniteti të caktuar jo shumicë

77. Gjykata fillimisht e sheh të nevojshme të sqarojë se neni 64 [Struktura e Kuvendit] i Kushtetutës përcakton që nga njëqind e njëzetë (120) deputetë sa janë gjithsej në Kuvend, njëzet (20) prej tyre janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

78. Në kuadër të kësaj kuote të garantuar, partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10) (në tekstin e më tejmë: deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb).

79. Ndërsa partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend, do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitetet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara (në tekstin e mëtejmë: deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë).

80. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se neni 64 i Kushtetutës sa i përket njëzet vendeve të garantuara në Kuvend për komunitetet jo shumicë në Kosovë, bënë ndarjen në mes të: *(i)* deputetëve që përfaqësojnë *"komunitetin Serb",* të cilët përfaqësohen në Kuvend me dhjetë (10) vende të garantuara; dhe *(ii)* deputetëve që përfaqësojnë *"komunitetet e tjera jo shumicë",* dhe atë komunitetet: Rom, Ashkali, Egjiptian, Boshnjak, Turk dhe Goran, të cilët, së bashku, përfaqësohen në Kuvend me dhjetë (10) vende të garantuara, sipas ndarjes së përcaktuar mes tyre në nenin e lartcekur të Kushtetutës. Andaj, në vijim të këtij Aktgjykimi, Gjykata do t'i referohet kësaj ndarjeje në mes të komuniteteve jo shumicë në Kuvend.

81. Në vazhdim, lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata, do t'u referohet kritereve kushtetuese lidhur me zgjedhjen, përbërjen dhe përfaqësimin e komuniteteve në Qeveri, në veçanti kritereve dhe procedurës për caktimin e ministrit të "tretë" që përfaqëson komunitetet jo shumicë.

82. Gjykata vëren se kriteret lidhur me zgjedhjen, përbërjen dhe përfaqësimin e komuniteteve në Qeveri janë të përcaktuara në Kapitullin VI [Qeveria e Republikës së Kosovës] të Kushtetutës, që në nenet 92-101 të saj, mes tjerash, përcaktohen parimet e përgjithshme për Qeverinë, kompetencat e Qeverisë dhe të Kryeministrit, procedurat për zgjedhjen e Qeverisë, si dhe mënyrën e përfaqësimit të komuniteteve në Qeveri. Gjykata, në vijim do elaborojë nenet 92 [Parimet e Përgjithshme], 95 [Zgjedhja e Qeverisë] dhe 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës, të cilat janë relevante për rastin konkret.

83. Në këtë aspekt, Gjykata së pari i referohet nenit 92 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës që përcakton se Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv dhe e cila përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.

84. Gjykata po ashtu i referohet nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës që përcakton mënyrën e zgjedhjes së Qeverisë. Më saktësisht, ashtu siç është sqaruar edhe në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO72/20, paragrafi 1 i nenit 95 të Kushtetutës, përcakton që Presidenti i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë. Paragrafët 2 dhe 3, përcaktojnë që ky kandidat, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, përkatësisht votën e gjashtëdhjetë e një (61) deputetëve (shih në këtë kontekst, Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO72/20, parashtrues: *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,* Aktgjykimit i 28 majit 2020, publikuar më 1 qershor 2020, paragrafi 428).

85. Megjithatë, Gjykata vëren se kriteret specifikë për përbërjen e Qeverisë dhe përfaqësimin e komuniteteve, janë përcaktuar në nenin 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës. Neni 96 i Kushtetutës në paragrafët 1 dhe 2 përcakton se ministritë dhe organet e tjera ekzekutive themelohen për kryerjen e funksioneve brenda kompetencave të Qeverisë dhe se numri i anëtarëve të Qeverisë

përcaktohet me aktin e brendshëm të saj. Ndërsa paragrafi 6 i nenit 96 të Kushtetutës parasheh që Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat e Qeverisë mund të zgjedhen nga radhët e deputetëve të Kuvendit ose persona të tjerë të kualifikuar, të cilët nuk janë deputetë të Kuvendit.

86. Ndërsa, përkundër faktit që konform paragrafit 2 të nenit 96 të Kushtetutës, numri i anëtarëve të Qeverisë përcaktohet me aktin e brendshëm të saj, paragrafët 3, 4 dhe 5 të po këtij neni të Kushtetutës përcaktojnë kritere të veçanta për përbërjen e Qeverisë, që në mënyrë specifike i referohen përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në Qeveri.

87. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se është kërkesë e qartë kushtetuese e paparë në paragrafin 3 të nenit 96 të Kushtetutës që në Qeveri të jenë së paku një (1) ministër nga komuniteti Serb, dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë. Për më tepër, sipas paragrafit 3 të nenit 96, nëse Qeveria përbëhet nga më shumë se dymbëdhjetë ministra, ajo do të ketë edhe një ministër të "tretë", i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë.

88. Andaj, ashtu siç theksohet edhe nga parashtruesit e kërkesës edhe nga Kryeministri, si përfaqësues i Qeverisë, Qeveria e zgjedhur sipas paragrafit 3 të nenit 95 të Kushtetutës, duhet t'i plotësojë edhe kriteret e përcaktuara në nenin 96, paragrafin 3 të Kushtetutës dhe atë që në përbërjen e saj të jetë: një (1) ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë, si dhe kriterin e përcaktuar në nenin 96, paragrafi 4 që në përbërjen e saj të ketë së paku dy (2) zëvendësministra nga komuniteti Serb i Kosovës dhe dy (2) zëvendësministra nga komunitete të tjera jo shumicë në Kosovë. Kjo ndarje e përfaqësimit në Qeveri është në përputhje edhe me përcaktimin e përfaqësimit në Kuvend të komuniteteve jo shumicë dhe terminologjinë e përdorur edhe në nenin 64 të Kushtetutës, i sqaruar më lart.

89. Për më tepër, nëse Qeveria përbëhet nga me tepër se dymbëdhjetë (12) ministri, atëherë caktohet edhe një ministër shtesë, përkatësisht ministri i "tretë" i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Qeveri si dhe një (1) zëvendësministër të tretë, i cili përfaqëson komunitetin Serb, dhe një (1) tjetër zëvendësministër, i cili përfaqëson një nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë. Gjykata vëren se sa i përket ministrit të "tretë" nga komunitetet jo shumicë, as paragrafi 3 i nenit 96 të Kushtetutës dhe as ndonjë dispozitë tjetër e Kushtetutës nuk përcakton nëse ministri i "tretë" duhet të jetë nga komuniteti Serb apo komunitetet e tjera jo shumicë. Gjuha e përdorur në paragrafin 3

të nenit 96 të Kushtetutës është e qartë kur flet për ministrin e *"tretë"*, përkatësisht kjo dispozitë vetëm përcakton që ky i fundit përfaqëson *"një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë"*. Gjykata vlerëson se ministri i "tretë" në Qeveri caktohet nga *"njëri nga"* komunitetet e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 64 të Kushtetutës të përfaqësuara në Kuvend, që në këtë rast nënkupton: ose nga *(i)* komuniteti Serb, ose nga *(ii)* komunitetet e tjera jo shumicë, në Kuvend. Përmes kësaj plotësohet kriteri kushtetues që ministri i "tretë" të përfaqësojë komunitetet jo shumicë në Qeveri.

90. Andaj, Gjykata përfundimisht thekson se sipas Kushtetutës, caktimi i ministrit të "tretë" në Qeveri nga komunitetet jo shumicë është detyrim kushtetues në rast se Qeveria përbëhet nga më shumë se dymbëdhjetë (12) ministri. Megjithatë, Kushtetuta nuk specifikon detyrim kushtetuese se cilin komunitet jo shumicë të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 64 të Kushtetues, e përfaqëson ministri i "tretë". Pra, kjo nuk nënkupton por as nuk e përjashton mundësinë që ministri i "tretë" në Qeveri nga komunitetet jo shumicë, të caktohet nga komuniteti Serb në Kosovë.

91. Gjykata vëren po ashtu se përfaqësimi i komuniteteve në Qeveri sipas paragrafit 3 të nenit 96 të Kushtetutës, është minimumi i përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë, në Qeverinë e Kosovës. Dispozitat relevante kushtetuese për përbërjen e Qeverisë mundësojnë që komunitetet jo shumicë të kenë përfaqësim më të madh në Qeveri, si pjesë e marrëveshjeve politike apo koalicioneve me partitë e tjera në Kuvend, që kanë fituar zgjedhjet dhe/apo që arrijnë të bëjnë shumicën e nevojshme prej të paktën gjashtëdhjetë e një (61) deputetëve, sipas paragrafit 3 të nenit 95 të Kushtetutës, për të formuar Qeverinë.

92. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Qeveria e Kosovës e zgjedhur përmes vendimit të kontestuar përveç faktit që përbëhet edhe nga tre (3) ministra nga komuniteti jo shumicë, ka në përbërjen e saj edhe një zëvendëskryeministër nga komunitetet jo shumicë e cila ka ardhur, jo si rezultat i kërkesave kushtetuese, por si rezultat i marrëveshjeve në mes të subjekteve politikë në Kuvend, të cilat përfaqësojnë komunitetet jo shumicë. Kjo është në pajtueshmëri të plotë me atë se neni 96 i Kushtetutës parasheh përfaqësimin minimal të komuniteteve në Qeveri, dhe nuk kufizohet vetëm në atë që përcakton Kushtetuta si minimum të përfaqësimit, por lejon që subjektet politike, duke përfshirë ato të komuniteteve jo shumicë të mund të arrijnë marrëveshje politike për ndarjen e pozitave ministrore dhe për përfaqësim në Qeveri, përtej përfaqësimit minimal dhe pjesëmarrjes së garantuar. Në vazhdim, Gjykata do të elaborojë procedurën që

duhet ndjekur lidhur me caktimin e ministrave që përfaqësojnë komunitetin jo shumicë në Qeveri.

(ii) Nëse caktimi i ministrave nga komunitetet jo shumicë, duke përfshirë caktimin e ministrit të "tretë" në Qeveri kërkon miratim formal nga të gjitha komunitetet jo shumicë

93. Marrë parasysh atë që Gjykata sqaroi më sipër se ministri i "tretë" në Qeveri nga komunitetet jo shumicë, nëse Qeveria i ka më shumë se dymbëdhjetë (12) ministri, mund të caktohet nga secili komunitet jo shumicë i përfaqësuar në Kuvend, në përputhje me ndarjen e vendeve në Kuvend sipas paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës, Gjykata në vazhdim do të elaborojë procedurën e zgjedhjes së ministrave që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Qeveri, dhe nëse për caktimin e ministrit të "tretë", kërkohet miratim formal i të gjitha komuniteteve jo shumicë në Kuvend. Kjo procedurë është e përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 96 të Kushtetutës.

94. Paragrafi 5 i nenit 96 të Kushtetutë përcakton: *"Zgjedhja e këtyre ministrave [...] do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse caktohen kandidatë jashtë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për këta ministra e zëvendësministra kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë"*.

95. Gjykata vëren se sipas dispozitave të lartcekura të paragrafit 5 të nenit 96 të Kushtetutës caktimi i ministrave nga komunitetet jo shumicë mund të bëhet si në vijim:

1) kur për ministër caktohet një përfaqësues i komunitetit jo shumicë <u>që është deputet i Kuvendit,</u> e ku sipas paragrafit 5 të nenit 96 të Kushtetutës, përveç konsultimit me partitë, me koalicionet ose me grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë, nuk kërkohet ndonjë aprovim formal nga deputetët e komuniteteve jo shumicë, me kushtin që të zgjedhet një (1) ministër nga Komuniteti Serb dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë. Ngjashëm, edhe sa i përket ministrit të "tretë" nga komunitetet jo shumicë, nëse Qeveria përbëhet nga më tepër se dymbëdhjetë (12) ministri, Kushtetuta nuk kërkon ndonjë miratim formal nga deputetët e komuniteteve jo shumicë, me kushtin që pas konsultimeve të caktohet një ministër që

përfaqëson komunitetet jo shumicë, nëse ky i fundit është deputet i Kuvendit; dhe

2) kur për ministër caktohet një përfaqësues i komunitetit jo shumicë <u>që nuk është deputet i Kuvendit</u> e ku sipas paragrafit 5 të nenit 96 të Kushtetutës, përveç konsultimeve paraprake, kërkohet në mënyrë specifike që ai kandidat të marrë miratimin formal të shumicës së deputetëve që përfaqësojnë komunitetin në fjalë. Në këtë aspekt, kjo procedurë zhvillohet si në rastet kur zgjedhet një (1) ministër nga Komuniteti Serb, ashtu, dhe një (1) ministër nga ndonjë komunitet tjetër jo shumicë në Kosovë, të cilët detyrimisht duhet të marrin votat e shumicës së deputetëve të komunitetit "tjetër jo shumicë". Ngjashëm, një miratim formal nga komuniteti *"në fjalë"* kërkohet edhe në rastet kur për ministër të "tretë" caktohet një person që i përket komunitetit jo shumicë në Kosovë, komunitetit Serb apo komunitetit tjetër jo shumicë, por nuk është deputet i Kuvendit të Kosovës.

96. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Kushtetuta, përkatësisht paragrafi 5 i nenit 96 të saj, lidhur me miratimin formal të kandidatëve nga komunitetet jo shumicë i referohet partisë, koalicioneve ose grupeve "*që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë",* por duke vënë theksin në fund të këtij paragrafi në *"komunitetin në fjalë"*.

97. Në këtë kontekst, Gjykata gjen se *(i)* lidhur me Ministrin që përfaqëson komunitetin Serb, kërkohet konsultimi me/miratimi nga (varësisht a është kandidati deputet apo jo) partitë, koalicionet ose me grupet që përfaqësojnë komunitetin Serb, në Kuvend. Në këtë aspekt, fjala është për dhjetë (10) deputetë që mbajnë vendet e garantuara për partitë, koalicionet, nismat qytetare, nga komuniteti Serb, sipas nenit 64, paragrafit 2, nënparagrafit 1 të Kushtetutës, elaboruar më lart. Ngjashëm edhe për *(ii)* caktimin e 1 (një) Ministri nga "komunitetet e tjera" jo shumicë, me ç'rast kandidati për këtë pozitë duhet të konsultohet me/marrë miratimin nga (varësisht a është kandidati deputet apo jo) partitë, koalicionet ose me grupet që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend. Kjo i referohet dhjetë (10) deputetëve që mbajnë vendet e garantuara për partitë, koalicionet, nismat qytetare, dhe atë komunitetet Rom; Ashkali; Egjiptian, Boshnjak, Turk dhe Goran, siç janë përcaktuar në nenin 64, paragrafi 2, nënparagrafi 2.

98. Ndërsa, për caktimin e ministrit të "tretë", kandidati për Kryeministër, konform paragrafit 3 të nenit 96, ka mundësi, pas konsultimit/miratimit nga (varësisht nëse kandidati është deputet apo jo) të caktojë një kandidat që i përket *"njërit nga komunitetet jo*

shumicë" të përfaqësuar në Kuvend. Pra në këtë rast, ose nga *(i)* partitë, koalicionet a grupet "*që përfaqësojnë komunitetin Serb" (si tërësi); ose* nga *(ii)* partitë, koalicionet ose grupet "*që përfaqësojnë komunitetet e tjerë jo shumicë"* (si tërësi), sipas ndarjes së paraparë në nenin 64 të Kushtetutës.

99. Andaj, Gjykata vlerëson se kandidati për Kryeministër detyrohet që për caktimin e ministrit nga komuniteti jo serb të konsultohet/të merr miratimin vetëm nga komuniteti serb, ndërsa për caktimin e ministrit nga komunitetet tjera jo shumicë duhet të konsultohet/të merr miratimin (varësisht nëse kandidati për ministër është deputet i Kuvendit apo jo) vetëm nga komunitetet tjera jo shumicë.

100. Për dallim nga kjo, për caktimin e ministrit të "tretë" në Qeveri, në këtë rast kandidati për Kryeministër përcaktohet se nga cili komunitetit "në fjalë", pra "komuniteti Serb" apo komuniteti "tjetër jo shumicë" dëshiron të emërojë ministrin e tretë. Dhe në këtë rast kandidati për Kryeministër (i) konsultohet me komunitetin "në fjalë"; ose (ii) merr miratimin e tyre (nëse kandidati nuk është deputet i Kuvendit), pra: ose (i) komunitetin Serb; ose (ii) komunitetet e tjera jo shumicë.

101. Ky interpretim përputhet edhe me qëndrimin e vet parashtruesve të kërkesës se *"Përfaqësimi i rezervuar i komuniteteve jo shumicë në Qeveri përbën të ashtuquajturin parim „të qeverisë së gjerë" në kuptim të multietnicitetit, dhe është një kusht kryesor i demokracisë konsociacionale [...]."*

102. Rrjedhimisht, dhe bazuar në të lartcekurat, Gjykata vlerëson se as neni 96 e as ndonjë dispozitë tjetër e Kushtetutës, nuk kërkon miratim formal për ministrin e "tretë" nga të gjithë deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë, në rast se ministri i "tretë" që caktohet nga radhët e komuniteteve jo shumicë, është deputet i Kuvendit.

103. Miratimi formal i ministrave nga komunitetit jo shumicë "në fjalë", nga komuniteti Serb ose nga komunitetet e tjera jo shumicë, kërkohet vetëm nëse caktohet një kandidat nga komuniteti jo shumicë në fjalë që nuk është deputet i Kuvendit, dhe kjo ndarje është bërë qartë në Kushtetutë. Nëse do të kërkohej një miratim formal edhe për kandidatët që janë deputetë të Kuvendit, atëherë ndarja e bërë në Kushtetutë lidhur me atë nëse një person është deputet i Kuvendit apo jo, për t'u caktuar ministër që përfaqëson komunitetet jo shumicë, nuk do të kishte kuptim.

(iii) Nëse kriteret e lartcekura janë zbatuar në rastin e tanishëm

104. Sa i përket rastit konkret, Gjykata vëren se më 14 shkurt 2021, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvend. Ndërsa pas numërimit të votave, më 13 mars 2021, KQZ certifikoi rezultatet e zgjedhjeve me ç'rast, LVV ishte partia fituese me pesëdhjetë e tetë (58) deputetë ndërsa njëzet (20) vende në Kuvend të cila janë të garantuara më Kushtetutë ishin ndarë për komunitetin jo shumicë, me ç'rast, Lista Serbe, që ishte deklaruar se përfaqëson komuniteti Serb në Kosovë kishte marrë dhjetë (10) deputetë, ndërsa dhjetë (10) vende të tjera ishin ndarë për komunitete të tjera jo shumicë në Kosovë, konform nenit 64 të Kushtetutës.

105. Gjykata vëren po ashtu se pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve nga KQZ, Kryetari i LVV-së si parti fituese e zgjedhjeve kishte filluar konsultimet me subjektet politike në Kosovë duke përfshirë edhe ato të komuniteteve jo shumicë. Në këtë kontekst, më 16 mars 2021, ishte mbajtur një takim në mes të përfaqësuesve të LVV-së dhe atyre të Listës Serbe. Takime të ngjashme ishin mbajtur edhe me përfaqësuesit e subjekteve politike të komuniteteve të tjera jo shumicë në Kosovë. Për më tepër, më 21 mars 2021, respektivisht më 22 mars 2021 kishin ndodhur shkëmbime letrash mes z. Albin Kurti, në cilësinë e tij si Kryetar i LVV-së dhe kandidat për Kryeministër dhe z.Goran Rakić, në cilësinë e këtij të fundit si Kryetar i Listës Serbe, lidhur me caktimin e përfaqësuesve të komunitetit Serb në Qeveri.

106. Më 22 mars 2021, U.d Presidenti nxori Dekretin Nr.61/2021 me të cilin *"Z. Albin Kurti i propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës."* Po atë ditë, përmes vendimit të kontestuar, nr. 08/V-005, Kuvendi me 67 vota "për", 30 "kundër" dhe asnjë abstenim zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës, të përbërë nga pesëmbëdhjetë (15) ministri. Tri (3) nga pozitat ministrore në Qeveri dhe një (1) pozitë e Zëvendës Kryeministrit, u ishin caktuar përfaqësuesve nga komunitetit jo shumicë dhe atë: *a)* z. Goran Rakić, Ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, nga komuniteti Serb, i cili pasi nuk kishte qenë deputet i Kuvendit, paraprakisht ishte votuar dhe kishte marrë 10 nga 10 votat e përfaqësuesve të komunitetit Serb ne Kuvend, konform paragrafit 5 të nenit 96 të Kushtetutës; *b)* Fikrim Damka, Ministër i Ministrisë për Zhvillim Rajonal, nga komuniteti tjetër jo shumicë, në këtë rast komuniteti turk; dhe *c)* Elbert Krasniqi, Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nga komuniteti jo shumicë, në këtë rast nga komuniteti Egjiptian në Kosovë, si ministër "i tretë" në Qeveri. Ndërsa, *d)* Emilija Redžepi, nga komuniteti jo shumicë, në këtë rast nga komuniteti Boshnjak në Kosovë, Zëvendëskryeministre për çështje të pakicave dhe të drejtat e njeriut.

107. Gjykata rikujton se kontestuese para Gjykatës është mënyra dhe procedura lidhur me caktimin e ministrit "të tretë" në Qeveri. Gjykata ka konstatuar më lart se Kushtetuta nuk kërkon miratim të propozimit të ministrit të "tretë" nga deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë, në rast se ministri i "tretë" nga komunitetet jo shumicë, është deputet i Kuvendit.

108. Në rastin konkret, ministri i "tretë" nga komunitetet jo shumicë, Elbert Krasniqi, lidhur me të cilin parashtruesit e kërkesës ankohen para Gjykatës, ka qenë deputet i Kuvendit i zgjedhur në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, i deklaruar se përfaqëson një nga komuniteti tjetër jo shumicë në Kuvend, në kuptim të nenit 64 të Kushtetutës, dhe i cili është caktuar për këtë pozitë pas konsultimeve me përfaqësuesit e komuniteteve të tjera jo shumicë në Kuvend, para votimit të Qeverisë.

109. Në këtë kontekst, komunitetet e tjera jo shumicë as nuk kanë paraqitur ndonjë pretendim se ata nuk janë konsultuar lidhur me caktimin e këtij të fundit si ministër, edhe pse atyre u ishte mundësuar nga Gjykata që të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën e dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës. As parashtruesit e kërkesës nuk e kontestojnë faktin që ka pasur diskutime lidhur me caktimin e ministrave nga komunitetet jo shumicë para zgjedhjes së Qeverisë, por pretendojnë se ministri i "tretë" është dashtë të ketë miratimin e shumicës së të gjithë njëzet (20) deputetëve të komuniteteve jo shumicë.

110. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesit e kërkesës argumentin e tyre për zgjedhjen e ministrit të tretë e ndërlidhin duke bërë krahasime me pozitat e tjera në Kuvend në të cilat përfaqësohen komunitetet jo shumicë, si dhe me pozita të tjera që zgjedhen nga Kuvendi, ku përfaqësohen komunitetet jo shumicë. Shembull për këtë ata marrin zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit që propozohet nga komuniteti Serb, por edhe emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

111. Megjithatë, rastet kur kërkohet miratimi i shumicës së të gjithë përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë, pra të 20 deputetëve të komunitetin jo shumicë (komunitetit Serb dhe komuniteteve të tjera jo shumicë, si tërësi), janë të përcaktuara në mënyrë shprehimore në Kushtetutë. Në këtë kontekst, sipas paragrafit 3 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], sa i përket propozimit të dy (2) gjyqtarëve, nga nëntë (9) sa ka Gjykata Kushtetuese, qëndron fakti se Vendimi për të propozuar dy (2) gjyqtarët e tjerë, merret me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, por që mund të bëhet vetëm pas dhënies së pëlqimit të

shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet që janë të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Por, siç u theksua, në këtë rast, një kërkesë e tillë parashihet në mënyrë shprehimore në paragrafin 3 të nenit 114 të Kushtetutës.

112. Për dallim prej rastit të lartcekur, në rastin e zgjedhjes së anëtarëve të Qeverisë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë, një kërkesë e tillë kushtetuese për votimin e anëtarëve të Qeverisë nga të gjitha komunitetet jo shumicë nuk parashihet në Kushtetutë pasi neni 96 paragrafi 5 i Kushtetutës vënë theksin në miratimin nga komuniteti *"në fjalë",* dhe jo nga të gjitha komunitetet jo shumicë. Dhe një kërkesë e tillë edhe është zbatuar në rastin e miratimit të propozimit të Ministrit Goran Rakić, ministër nga komuniteti Serb, i cili, pasi nuk ishte deputet i Kuvendit, sipas transkriptit të Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Kuvendit, të 22 marsit 2021, ishte votuar fillimisht nga deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb dhe pastaj ishte përfshirë për votim në përbërjen e plotë të Qeverisë. Sikur qëllimi i kushtetutëbërësit të ishte që ministri i "tretë" të caktohet pas miratimit të shumicës së deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvend, kjo do të precizohej në dispozitat relevante të Kushtetutës, njësoj sikurse që u shpjegua më lart, me rastin e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

113. Andaj, bazuar në atë që u tha më sipër, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesve të kërkesës për shkelje të paragrafëve 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës, me rastin e caktimit të ministrit të "tretë" në Qeveri, nuk është i bazuar.

114. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar është në pajtueshmëri me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës.

Lidhur me kërkesën për mbajtje të seancës dëgjimore

115. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë kërkuar nga Gjykata që të mbajë seancë dëgjimore në të cilën do të ftonte të gjithë deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kosovë që të përcaktojë çështjet që ndërlidhen me përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në Qeveri.

116. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në bazë të paragrafit (1) të rregullit 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës: *"Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës, përveç nëse Gjykata, me shumicë votash, vendos ndryshe*

pas një arsyetimi të mirë"; ndërsa, në bazë të paragrafi (2) të po të njëjtit rregull: *"Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit".*

117. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ai rregull vetëm parasheh mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo beson se është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit. Pra, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo konsideron se faktet ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur tek një vendim meritor lidhur me rastin që është në shqyrtim (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO43/19, parashtruese: *Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 13 qershorit 2019, paragrafi 116; shih gjithashtu rastin, KI34/17, parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110).

118. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth "provave apo ligjit" dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet dhe shkresat të cilat janë pjesë e dosjes së rastit KO61/21 janë të mjaftueshme për të vendosur këtë rast.

119. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesve të kërkesës për mbajtje të seancës dëgjimore refuzohet si e pabazuar.

Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme lidhur me vendimin e kontestuar

120. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës, gjithashtu kërkojnë nga Gjykata që të nxjerrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme "*me të cilën do ta vendoste në gjendje qetësie pozitën e ministrit i cili u emërua Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal - Elbert Krasniqi sepse nuk e ka mbështetjen e (11) njëmbëdhjetë deputetëve që përbën shumicën e (20) njëzet deputetëve të cilët përfaqësojnë komunitetet jo shumicë*".

121. Gjykata më sipër ka konkluduar se vendimi i kontestuar është në pajtueshmëri me nenin 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës.

122. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 [Masat e Përkohshme] të Ligjit dhe me rregullin 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të

Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme, është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, refuzohet.

Përfundim

123. Çështja kryesore që ngërthen ky rast ndërlidhet me mënyrën e caktimit të ministrave që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Qeveri. Para Gjykatës, nuk ishte kontestuese mënyra e caktimit të një (1) ministri që caktohet detyrimisht nga komuniteti Serb; ose një (1) ministri që caktohet detyrimisht nga komunitetet e tjera jo shumicë, por caktimi i ministrit të "tretë" në Qeveri nga komunitetet jo shumicë, që është detyrim kushtetues në rast se Qeveria përbëhet nga më tepër se dymbëdhjetë (12) ministra. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës pretenduan se për caktimin e ministrit të "tretë" në Qeveri është i nevojshëm konsultimi/miratimi nga shumica e të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë në Kuvend, përkatësisht nga të paktën njëmbëdhjetë (11) nga njëzet (20) deputetët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë.

124. Gjykata Kushtetuese theksoi se, për qëllime të kushtetutshmërisë së përbërjes së Qeverisë, bazuar në nenin 96 të Kushtetutës, në Qeveri duhet të jenë së paku një (1) ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) ministër nga komunitetet e tjera jo shumicë. Mënyra e zgjedhjes së këtyre ministrave dallon varësisht nëse kandidati i propozuar për ministër është deputet i Kuvendit ose jo. Për caktimin e një kandidati për ministër nga radhët e deputetëve të Kuvendit, është i nevojshëm *konsultimi* me partitë, koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Ndërsa, për caktimin e një kandidati për ministër jashtë radhëve të deputetëve të Kuvendit, është i nevojshëm miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë. Gjykata Kushtetuese gjithashtu theksoi se, Kushtetuta përcakton që në rast se përbërja e një Qeverie ka më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, Qeveria duhet të ketë edhe një ministër të tretë, *"i cili përfaqëson një nga komunitetet jo shumicë në Kosovë"*. Gjykata tutje theksoi se, për sa i përket ministrit të tretë, Kushtetuta i mundëson diskrecion mandatarit për Kryeministër përkitazi me radhët e komuniteteve përkatëse, nga të cilët mund të zgjedhet një ministër i tretë, duke mos përcaktuar detyrimisht që ky ministër duhet të propozohet/miratohet nga deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb ose nga deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë, por duke kërkuar që të ndiqet procedura e njëjtë përkatësisht konsultimi/miratimi i "*komunitetit në fjalë*", varësisht nëse kandidati përkatës është deputet i Kuvendit ose jo.

125. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata theksoi se ministri i "tretë" nga komunitetet jo shumicë, përkatësisht Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, ishte deputet i Kuvendit i zgjedhur në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, i deklaruar se përfaqëson një nga komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend në kuptim të nenit 64 [Struktura e Kuvendit] të Kushtetutës dhe i cili është propozuar për këtë pozitë në konsultim me deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë në Kuvend. Duke marrë parasysh që kandidati përkatës ishte deputet i zgjedhur i Kuvendit, miratimi formal nga komuniteti në fjalë nuk është detyrim kushtetues, ndërsa para Gjykatës nuk kishte asnjë pretendim që deputetët që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë nuk ishin konsultuar në propozimin e këtij kandidati për ministër, përkundër faktit që Gjykata u kishte mundësuar që të paraqesin komentet e tyre lidhur me kërkesën e dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës.

126. Gjykata përfundimisht sqaroi që bazuar në nenin 96 të Kushtetutës, i detyrueshëm është konsultimi me ose miratimi i deputetëve që përfaqësojnë "*komunitetin në fjalë*", përkatësisht deputetët që përfaqësojnë komunitetin Serb ose që përfaqësojnë komunitetet e tjera jo shumicë, varësisht nëse kandidati përkatës është deputet i Kuvendit ose jo, dhe jo shumica e të gjithë deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë. Në rrethanat e rastit konkret, kandidati i propozuar për ministër ishte deputet i Kuvendit dhe për pasojë miratimi formal i tij nuk ishte detyrim kushtetues, ndërsa para Gjykatës nuk kishte asnjë pretendim që detyrimi për konsultimin e "*komunitetit në fjalë*" nuk ishte shteruar. Prandaj, **Gjykata konstatoi që**, **Vendimi** i kontestuar i Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë **nuk është nxjerrë në kundërshtim** me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 **të Kushtetutës**.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113, paragrafi 5 të Kushtetutës, neneve 27, 42 dhe 43 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullave 42, 57, 59 (1) dhe 74 të Rregullores së punës, më 24 shtator 2021;

VENDOS

I. TË SHPALLË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, që procedura për nxjerrjen e Vendimit nr.08/V-005 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 22 marsit 2021, është zhvilluar në pajtueshmëri me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës;

III. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;

IV. TË REFUZOJË, me shumicë votash, kërkesën për mbajtjen e seancës dëgjimore;

V. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

VI. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me
nenin 20, paragrafi 4 të Ligjit; dhe

VII. TË SHPALLË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Gresa Caka-Nimani

KI94/21, Parashtrues: Fatmir Hoti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 5974/2020, të 11 dhjetorit 2020

KI94/21, Aktvendim për Papranueshmëri, i 23 shtatorit 2021, publikuar më 12 tetor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, kërkesë për masë të sigurisë, mungesë e vendimit të arsyetuar gjyqësor, kërkesë ratione materiae, kërkesë e papranueshme, mungesë evidente e shkeljes, pretendim i pambështetur dhe paarsyetuar*

Gjykata rikujton që rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës të parashtruar në Gjykatën Themelore në Gjakovë kundër E.H për pagesën e borxhit ndaj tij në vlerë prej 470.000, 00 euro. Si rezultat i kërkesëpadisë së tij, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Prishtinë kishte kërkuar caktimin e masës së sigurisë ndaj paluejtshmërive në emër të E.H, e cila kërkesë ishte aprovuar përmes Aktvendimit [C.nr. 1710/15] të 21 tetorit 2015 të kësaj gjykate. Megjithatë, më 4 shtator 2019, E.H në të njëjtën gjykatë, respektivisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë kishte parashtruar kërkesë për anulimin e masës së sigurisë të caktuar nga kjo gjykatë me arsyetimin se(i) parashtruesi i kërkesës me Aktgjykimin e formës së prerë [PKR. Nr. 23/14] të 16 majit 2016, të Gjykatës Themelor në Gjakovë ishte shpallur fajtor dhe dënuar me një vit e gjashtë muaj burgim për kryerjen e veprës penale "Kontraktimi i përfitimit joproporcional"; (ii) se parashtruesi i kërkesës me qëllim të shmangies së vuajtjes së dënimit, si rezultat i këtij Aktgjykimi gjendet në arrati; dhe (iii) se kërkesën e tij për masë të sigurisë, parashtruesi i kërkesës e ka bazuar me veprim të inkriminuar. Gjykata Themelore në Prishtinë pas mbajtjes së seancës dëgjimore, ku kishte dëgjuar palët ndërgjygjëse dhe administrimit të provave të bashkëngjitura kishte vendosur që të anulojë masën e sigurisë ndaj paluejtshmërive në emër të E.H. Në Aktvendimin e saj, Gjykata Themelore duke në Prishtinë duke iu referuar paragrafit 1 të nenit 309 dhe paragrafit 2 të nenit 312 të LPK-së kishte konstatuar se rrethanat në bazë të cilave ishte caktuar masa e sigurisë kishin ndryshuar. Kundër këtij Aktvendimi të Gjykatës Themelore në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, me pretendimin thelbësor se Gjykata Themelore nuk kishte arsyetuar vendimin e saj me faktet dhe kushtet ligjore mbi bazën e të cilave mund të caktohet dhe anulohet masa e caktuar e sigurisë. Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac. Nr. 5974/2020] të 11 dhjetorit 2020 ankesën e parashtruesit të kërkesës e kishte refuzuar si të pabazuar duke e vërtetuar Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij, pretendoi shkelje të të drejtave themelore të tij të garantuara (i) me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ)-së, si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor; dhe (ii) me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Fillimisht, në kontekst të pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata duke marrë për bazë faktin se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ndërlidhet me caktimin e masës së sigurisë, të nxjerrë në procedurë paraprake shqyrtoi nëse kërkesa është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, përkatësisht shqyrtoi dhe vlerësoi nëse në këtë rast janë të aplikueshmë garancitë procedurale të përcaktuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë kontekst, Gjykata duke aplikuar kriteret e përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës konstatoi se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës janë plotësuar kriteret për aplikueshmërinë e garancive procedurale të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata vazhdoi me shqyrtimin e pretendimit për shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor.

Gjykata sërish duke aplikuar parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës përkitazi me arsyetimin e vendimit gjyqësor, konstatoi se Gjykata e Apelit ka adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura në ankesën e tij përkitazi me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, përmes të cilit ishte anuluar caktimi i masës së sigurisë ndaj paluejtshmërive në emër të E.H. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit nuk karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Për pasojë, Gjykata konstatoi se pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese në "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*" ashtu siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

Ndërsa, përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të drejtës së tij, në pronë, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së konsideroi se ky pretendim i tij është pretendim "*i pambështetur apo paarsyetuar*", dhe rrjedhimisht, i papranueshëm siç është përcaktuar përmes nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI94/21

Parashtrues

Fatmir Hoti

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit,
Ac. nr. 5974/2020, të 11 dhjetorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fatmir Hoti, me vendbanim në Gjakovë, i përfaqësuar me autorizim nga Teki Bokshi, avokat në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Ac. Nr. 5974/2020] të 11 dhjetorit 2020 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktvendimin [C. Nr. 1710/15] të 23 shtatorit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

3. Parashtruesi i kërkesës Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit e ka pranuar më 20 janar 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), si dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 17 maj 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.

7. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

8. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

9. Më 4 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të

përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi.

10. Më 11 qershor 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të dorëzojë ankesën e tij të parashtruar në Gjykatën e Apelit.

11. Të njëjtën ditë, Gjykata i dorëzoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit dhe i dorëzoi Gjykatës Themelore kërkesën që të dorëzojë fletëkthesën e cila dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit.

12. Më 17 qershor 2021, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën, e cila dëshmon se parashtruesi i kërkesës Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit e ka pranuar më 20 janar 2021.

13. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

14. Më 7 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kopjen e ankesës të parashtruar në Gjykatën e Apelit, të kërkuar nga Gjykata.

15. Më 23 shtator 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Sipas shkresave të lëndës, rezulton që parashtruesi i kërkesës më 17 prill 2014 në Gjykatën Themelore në Gjakovë kundër E.H kishte parashtruar padi për pagesën e borxhit në vlerë prej 470.000, 00 euro.

17. Më 24 korrik 2015, si rezultat i kërkesëpadisë së lartcekur, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Prishtinë kishte parashtruar kërkesën për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë ndaj paluejtshmërive të E.H, të regjistruara në Zonën Kadastrale të Komunës së Obiliqit me kërkesën specifike që të ndalohet tjetërsimi dhe ngarkimi me hipotekë apo ndryshimi gjendjes së ndërtimit të këtyre paluejtshmërive.

18. Më 21 tetor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktvendimit [C.nr. 1710/15] caktoi masën e sigurisë dhe të paditurit, gjegjësisht kundërshtarit të sigurimit E.H i ndaloi që të tjetërsojë, të ngarkojë me hipotekë apo të ndryshojë gjendjen me ndërtim apo në çfarëdo mënyre tjetër në paluejtshmërinë e lartcekur. Në të njëjtën kohë, Gjykata Themelore detyroi Zyrën Kadastrale në Komunën e Obiliqit dhe Odën e Noterëve që masën e sigurisë të vendosur sipas pikës së parë të dispozitivit të këtij Aktvendimi ta evidentojnë në regjistrat përkatës.

19. Më 4 shtator 2019, E.H kishte parashtruar kërkesë në Gjykatën Themelore për anulimin e masës së sigurisë ndaj paluejtshmërive të lartcekura me arsyetimin se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës dhe kërkesa e tij për caktimin e masës së sigurisë bazoheshin në prova të rreme. Në kërkesën e tij E.H kishte theksuar se: (i) parashtruesi i kërkesës me Aktgjykimin e formës së prerë [PKR. Nr. 23/14] të 16 majit 2016, të Gjykatës Themelor në Gjakovë ishte shpallur fajtor dhe dënuar me një vit e gjashtë muaj burgim për kryerjen e veprës penale "Kontraktimi i përfitimit joproporcional"; (ii) se parashtruesi i kërkesës me qëllim të shmangies së vuajtjes së dënimit, si rezultat i këtij Aktgjykimi gjendet në arrati; dhe (iii) se kërkesën e tij për masë të sigurisë, parashtruesi i kërkesës e ka bazuar me veprim të inkriminuar.

20. Më 23 shtator 2020, Gjykata Themelore, pas mbajtjes së seancës dëgjimore përmes Aktvendimit [C.nr.1710/15] anuloi Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore, të 21 tetorit 2015 për caktimin e masës së sigurisë kundër E.H duke e liruar paluejtshmërinë e lartcekur nga masa e sigurisë.

21. Gjykata Themelore në Aktvendimin e saj theksoi se vendimin e saj e mbështet në provat e bashkëngjitura në propozimin për caktimin e masës së sigurisë; provave të bashkëngjitura në kërkesën për anulimin e masës së sigurisë, të parashtruar nga E.H; Aktgjykimin e formës së prerë [PKR. Nr. 23/14] të 16 majit 2016, të Gjykatës Themelore në Gjakovë, të vërtetuar përmes Aktgjykimit [PAKR. Nr. 421/2016] të 9 shtatorit 2016; dhe deklaratave të palëve ndërgjyqëse gjatë seancës së mbajtur dëgjimore.

22. Gjykata Themelore, në fund duke iu referuar paragrafit 1 të nenit 309 dhe paragrafit 2 të nenit 313 të LPK-së dhe pa paragjykuar vendosjen në merita të padisë kryesore të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës vendosi që të anulojë caktimin e masës së sigurisë me arsyetimin se kishin ndryshuar kushtet dhe rrethanat në bazë të të cilave është caktuar masa e sigurimit.

23. Kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën e Apelit parashtroi ankesë për shkak të: (i) shkeljeve thelbësorë të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) zbatimit të gabuar të gjendjes materiale. Parashtruesi i kërkesës në thelb pretendoi se Gjykata Themelore nuk kishte dhënë arsyetim për faktet dhe kushtet ligjore mbi bazën e të cilave mund të caktohet apo anulohet masa e sigurisë; nuk kishte dhënë arsyetim lidhur me besueshmërinë e kërkesës së tij për caktimin e masës së sigurisë dhe nuk kishte vlerësuar dhe adresuar pretendimet e tij në seancën dëgjimore.

24. Më 11 dhjetor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. Nr. 5974/2020] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore.

25. Gjykata e Apelit vlerësoi se Gjykata Themelore në Prishtinë, e cila vendimin e saj e ka bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 16 majit 2016, përmes të cilës ishte shpallur fajtor dhe dënuar për veprën penale të "kontraktimit të përfitimit joproporcional" e vërtetuar me Aktgjykimin [PAKR.nr.421/2016] të 9 shtatorit 2016, të Gjykatës së Apelit dhe duke iu referuar paragrafit 1 të nenit 309 dhe paragrafit 2 të nenit 313 të LPK-së drejt ka vendosur kur ka anuluar vendimin e saj për caktimin e masës së sigurisë.

26. Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj po ashtu iu referuar paragrafit 1 të nenit 309, dhe paragrafit 2 të nenit 313 të LPK-së, duke theksuar se përmes këtyre dispozitave është paraparë mundësia e gjykatës që të anulojë vendimin e vet për caktimin e masës së sigurisë në rast të ndryshimit të rrethanave për shkak të cilave është caktuar masa e sigurisë.

27. Në vijim, Gjykata e Apelit, pa paragjykuar vendosjen e çështjes në merita sipas kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës të parashtruar në Gjykatën Themelore në Gjakovë [me numër të lëndës C. Nr. 212/2014], përfundimisht konstatoi se Aktvendimi [C.nr.1710/15] i 23 shtatorit 2020, i Gjykatës Themelore në Prishtinë për anulimin e masës së sigurimit nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

28. Gjykata, në vijim, po ashtu i referohet faktit se parashtruesi i kërkesës më 9 shkurt 2017 dhe 27 janar 2020, respektivisht kishte dorëzuar kërkesa në Gjykatë, të regjistruara me numër KI09/17 dhe 18/20, respektivisht.

(i) Procedura e zhvilluar që përbente objekt të çështjes së vlerësimit nga Gjykata në rastin KI09/17 ndërlidhej me procedurën e rregullt penale kundër parashtruesit të kërkesës, në kuadër të së cilës ishte nxjerrë Aktgjykimi [Pml. nr. 281/2016] i 5 dhjetorit 2016, i Gjykatës Supreme të Kosovës, përmes të cilit ishte refuzuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të lartcekur [PKR. Nr. 23/14] të 16 majit 2016 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, përmes të cilit ai ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të kontraktimit të fitimit joproporcional dhe dënuar me burgim në kohëzgjatje prej një viti e gjashtë muaj dhe Aktgjykimit [PAKR nr. 421/2016] të 9 shtatorit 2016 të Gjykatës së Apelit. Gjykata përmes Aktvendimit për Papranueshmëri, të 5 shtatorit 2017 kërkesën e parashtruesit të kërkesës e shpalli të papranueshme si qartazi të pabazuar në bazë kushtetuese ashtu siç ishte përcaktuar me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës në atë kohë në fuqi; dhe

(ii) Procedura e zhvilluar që përbente objekt të çështjes së vlerësimit nga Gjykata në rastin KI18/20 ndërlidhej me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishikimin e procedurës penale të lartcekur, në kuadër të së cilës si vendim i fundit i nxjerrë në këtë procedurë ishte Aktvendim [PN. nr. 794/2019] i 23 korrikut 2019, i Gjykatës së Apelit përmes të cilit ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit [PK. nr. 278/19] të 3 korrikut 2019, të Gjykatës Themelore në Gjakovë. Përmes Aktvendimeve të lartcekura nga gjykatat e rregullta ishte konstatuar se nuk ishin plotësuar kriteret ligjore të përcaktuar me dispozitat e procedurës penale për rishikim të procedurës penale. Gjykata përmes Aktvendimit për Papranueshmëri, të 17 dhjetorit 2020 kërkesën e parashtruesit të kërkesës e shpalli si të papranueshme *ratione materiae* me Kushtetutën ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
30. Përkitazi me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore përkitazi me anulimin e masës së sigurisë nuk përmbushin standardet

e një vendimi të arsyetuar gjyqësor. Thënë këtë, parashtruesi i kërkesës specifikon se gjykatat e rregullta nuk kanë ofruar arsyetim në lidhje me faktet dhe kushtet ligjore mbi bazën e së cilave caktohet ose mund të anulohet masa e sigurisë.

31. Në mbështetje të pretendimit të tij, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të Gjykatës KI07/18, me parashtrues *Çeliku Rrollers* (Aktgjykim, i 18 dhjetorit 2019), gjegjësisht paragrafëve 99-101 të këtij Aktgjykimi, në të cilat Gjykata i është referuar praktikës së vet gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, garanci kjo e mishëruar në nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

32. Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson se duke filluar nga viti 2015, kundërpropozuesi [E.H] ndaj të cilit ishte caktuar masa e sigurisë me veprimet e tij në vazhdimësi kishte dëmtuar pasurinë e parashtruesit të kërkesës.

33. Përkitazi me pretendimin për nenin 1 të Protokollit nr. 1, parashtruesi i kërkesës nuk specifikon dhe arsyeton se si e drejta e pronës është shkelur në rastin e tij.

34. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata të: (i) deklarojë kërkesën e tij si të pranueshme; (ii) të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së*;* (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e kontestuar [Ac. Nr. 5974/2020] të 11 dhjetorit 2020 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [C. Nr. 1710/15] të 23 shtatorit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Dispozita relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

NENI 6
E drejta për një proces të rregullt

4. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Protokoll shtesë i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

NENI 1
Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 309

309.1 Masa e sigurimit e caktuar me vendim të gjykatës mbetet në fuqi deri sa mos të jepet vendim tjetër mbi masën e sigurimit.

[...]

Neni 313

[...]

313.2 Me propozim të kundërshtarit të sigurimit procedura e filluar do të përfundohet dhe veprimet e kryera do të anulohen, po që se rrethanat për shkak të të cilave është caktuar masa e sigurimit, më vonë kanë ndryshuar dhe e kanë bërë të pa nevojshme atë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

37. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

38. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është: palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Ac. Nr. 5974/2020] të 11 dhjetorit 2020 të Gjykatës së Apelit; ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe, e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.

39. Në vijim dhe me qëllim të vlerësimit të kritereve tjera të pranueshmërisë, Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij, pretendon shkelje të të drejtave themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; dhe me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

I. Përkitazi me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

40. Bazuar në atë si më lart, Gjykata vë në pah se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

41. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret dhe në kontekst të pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht i referohet pikës (b) të paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës, sipas së cilës, Gjykata mund të konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

42. Prandaj, në kontekst të kësaj të fundit, vlerësimi i këtij kriteri në rrethanat e rastit, është i rëndësishëm sepse procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta hyjnë në fushëveprimin e "procedurave paraprake", përkatësisht Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ndërlidhet me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë për

anulimin e masës së sigurisë, e cila ishte caktuar nga kjo e fundit përmes Aktvendimit [C.nr. 1710/15] të saj të 21 tetorit 2015 derisa kërkesëpadia për kthimin e borxhit e parashtruar në Gjykatën Themelore në Gjakovë është akoma në procedurë të shqyrtimit të meritave. Rrjedhimisht, Gjykata do të vlerësojë nëse neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është i zbatueshëm në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës.

43. Në këtë kontekst specifik, Gjykata vëren se çështja e aplikueshmërisë së nenit 6 të KEDNJ-së në procedura paraprake është interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikes së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën Gjykata, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejta e Njeriut] të Kushtetutës, është e obliguar të interpretoje të drejtat e njeriut dhe liritë themelore te garantuara me Kushtetutë.

44. Gjykata vë po ashtu në pah, se kriteret përkitazi me aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës përkitazi me procedurat paraprake janë përcaktuar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI122/17, me parashtrues, *Česká Exportní Banka A.S.,* Aktgjykim i 30 prillit 2018; KI150/16, parashtrues *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2018; KI81/19, parashtrues *Skender Podrimqaku,* Aktvendim për papranueshmëri i 9 nëntorit 2019; KI107/19, parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020; KI195/20 me parashtrues *Aigars Kesengfelds*, Aktgjykim, i 29 marsit 2021. Parimet e përgjithshme të vendosura përmes këtyre vendimeve të lartcekura të Gjykatës janë bazuar në rastin e GJENDJ-së, *Micallef kundër Maltës*, Aktgjykim i 15 tetorit 2009.

45. Rrjedhimisht, për të konstatuar nëse kërkesa e parashtruesit të kërkesës është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, Gjykata fillimisht do të iu referohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore e GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës për sa i përket aplikueshmërisë së garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në rrethanat e rastit konkret, dhe të cilat ndërlidhen me procedurën për anulimin e masës së sigurisë, e cila përbën objektin e vlerësimit të kësaj kërkese, dhe më pas të njëjtat do t'i aplikojë në rrethanat e rastit konkret.

(iii) Parimet e përgjithshme mbi aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 te KEDNJ-së në procedurat paraprake

46. Gjykata fillimisht vë në pah se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ -se, në pjesën civile, zbatohet në procedurat që përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile (shih rastin e GJEDNJ-së: *Ringeisen*

kundër Austrisë, Aktgjykim i 22 qershorit 1972, dhe shih rastet e Gjykatës: KI 122/17, parashtrues i kërkesës *Česká Exportní Banka A.S.,* të cituar më lart, paragrafi 125 dhe KI195/20, me parashtrues *Aigars Kesengfelds*, të cituar më lart, paragrafi 73). Në kontekst të kësaj, Gjykata më tutje thekson se, në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, "procedurat paraprake", si ato që kanë të bëjnë me dhënien e një mase të përkohshme/masë të sigurisë, nuk konsiderohen që përcaktojnë të "drejta dhe detyrime civile" dhe për këtë arsye, në parim, nuk hyjnë në kuadër të fushëveprimit të mbrojtjes së tillë të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 75 dhe referencat e përdorura në të, shih rastin KI122/17, parashtrues i kërkesës *Česká Exportní Banka A.S.,* paragrafi 126).

47. Megjithatë, përmes Aktgjykimit *Micallef kundër Maltës*, GJEDNJ kishte ndryshuar dhe konsoliduar qëndrimin e saj të mëparshëm përkitazi me mos aplikueshmërinë e garancive procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së në "procedurat paraprake".

48. Përmes këtij Aktgjykimi, GJEDNJ vlerësoi si në vijim:

> *"79. Përjashtimi i masave të përkohshme nga fushëveprimi i nenit 6 deri tani është justifikuar me faktin që ato, në parim, nuk përcaktojnë detyrime dhe të drejta civile. Megjithatë, në kushtet kur shume Shteteve Kontraktuese u duhet te përballen me një akumulim te konsiderueshëm çështjesh për shkak te mbingarkesës së sistemeve te tyre të drejtësisë, gjë që çon në procese të tej zgjatura, vendimi i një gjyqtari për një urdhër ndalues shpesh ndodh që është i barasvlefshëm me një vendim për themelin e çështjes për një kohë të konsiderueshme, nganjëherë edhe përgjithmonë. Rrjedhimisht, shumë herë ndodh që procedurat për masa provizore dhe ato në lidhje me veprimin ligjor kryesor vendosin për të njëjtat "detyrime dhe të drejta civile" dhe japin të njëjtat efekte afat-gjata apo edhe të përhershme."* (shih rastin e GJEDNJ-se: *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim, [DHM], 15 tetor 2009, paragrafi 79)".

49. Bazuar në këtë Aktgjykim të GJEDNJ-së, Gjykata vëren se jo të gjitha masat e sigurisë/masat e përkohshme përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile dhe në mënyrë që neni 6 i KEDNJ-së të konsiderohet i zbatueshëm, GJEDNJ përcaktoi kriteret mbi bazën e të cilave duhet të vlerësohet aplikueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së në "proceduarat paraprake" (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafët 83-86).

50. Sipas kritereve të përcaktuar në rastin *Micallef kundër Maltës*, të cilat kritere edhe kjo Gjykatë i pranoi përmes praktikës gjyqësore, së pari, e drejta në fjalë duhet të jetë "civile" si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe ne procedurat lidhur me masën e sigurisë, brenda kuptimit autonom të këtij nocioni sipas nenit 6 të KEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 84 dhe referencat e përmendura aty, si dhe shih rastet e Gjykatës KI122/17, parashtrues *Česká Exportní Banka A.S.*, të cituar më lart, paragrafi 130; KI81/19, parashtrues *Skender Podrimqaku*, të cituar më lart, paragrafi 47; KI107/19, parashtrues *Gafurr Bytyqi*, të cituar më lart, paragrafi 53; dhe KI195/20, me parashtrues *Aigars Kesengfelds*, të cituar më lart, paragrafi 77). Së dyti, kjo procedurë duhet të përcaktojë në mënyrë efektive të drejtën civile përkatëse (shih rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, cituar më lart, paragrafi 85 dhe referencat e përmendura aty, si dhe shih rastet e Gjykatës, KI122/17, parashtrues *Česká Exportní Banka A.S.*, të cituar më lart, paragrafi 131 dhe KI81/19, parashtrues *Skender Podrimqaku*, të cituar më lart, paragrafi 48; KI107/19, parashtrues *Gafurr Bytyqi,* të cituar më lart, paragrafi 53; dhe KI195/20, me parashtrues *Aigars Kesengfelds*, të cituar më lart, paragrafi 77).

51. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të vlerësoj në vijim, nëse këto dy kritere, janë të përmbushura në rrethanat e rastit konkret, duke mundësuar për pasojë, aplikueshmërinë e garancive procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

(iv) Zbatimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e parashtruesit të kërkesës

52. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës i referohen kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës të parashtruar në Gjykatën Themelore në Gjakovë kundër E.H për pagesën e borxhit në shumë prej 470.000, 00 euro. Si rezultat i kësaj kërkesëpadie, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për caktimin e masës së sigurisë ndaj paluejtshmërive në emër të E.H., duke rezultuar kështu në ekzistimin e një të drejtë civile.

53. Rrjedhimisht, qëllimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurisë është që të paktën për një periudhë të caktuar kohore të sigurojë të njëjtën të drejtë që kontestohet edhe në procedurë kontestimore përkitazi me meritat e rastit. Caktimi i masës së sigurisë në procedurë kontestimore është paraparë në nenet 296-319 të LPK-së.

54. Prandaj, bazuar në atë si më lartë, Gjykata gjen se kriteri i parë për aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në procedurat përkatëse paraprake është i përmbushur.

55. Në vijim, Gjykata më tej vëren se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, caktimi i masës së sigurisë ishte përcaktues për këtë të drejtë sepse i njëjti është mekanizëm i mundshëm për parashtruesin e kërkesës për të siguruar pagesën e borxhit ndaj tij, e cila përbën edhe objektin e kërkesëpadisë së tij të parashtruar në Gjykatën Themelore në Gjakovë. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se edhe kriteri i dytë për aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në procedurat përkatëse paraprake, është i përmbushur.

56. Prandaj, Gjykata konstaton që në rrethanat e të parashtruesit të kërkesës, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, janë plotësuar kriteret për aplikueshmërinë e garancive procedurale të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

57. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është *ratione materiae* në pajtim më Kushtetutën.

58. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës. Në mënyrë specifike, rregulli 39 (2) përcakton që:

> *"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."*

59. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *"të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*". Këtë koncept të

papranueshmërisë mbi bazën e një kërkese të vlerësuar si "*qartazi të pabazuar*", dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si "*qartazi të pabazuara*" të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20 me parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; dhe KI21/21, me parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021).

60. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

61. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës të parashtruar në Gjykatën Themelore në Gjakovë kundër E.H për pagesën e borxhit ndaj tij në vlerë prej 470.000, 00 euro. Si rezultat i kërkesëpadisë së tij, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Prishtinë kishte kërkuar caktimin e masës së sigurisë ndaj paluejtshmërive në emër të E.H, e cila kërkesë ishte aprovuar përmes Aktvendimit [C.nr. 1710/15] të 21 tetorit 2015 të kësaj gjykate. Megjithatë, më 4 shtator 2019, E.H në të njëjtën gjykatë, respektivisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë kishte parashtruar kërkesë për anulimin e masës së sigurisë të caktuar nga kjo gjykatë me arsyetimin se(i) parashtruesi i kërkesës me Aktgjykimin e formës së prerë [PKR. Nr. 23/14] të 16 majit 2016, të Gjykatës Themelor në Gjakovë ishte shpallur fajtor dhe dënuar me një vit e gjashtë muaj burgim për kryerjen e veprës penale "Kontraktimi i përfitimit joproporcional"; (ii) se parashtruesi i kërkesës me qëllim të shmangies së vuajtjes së dënimit, si rezultat i këtij Aktgjykimi gjendet në arrati; dhe (iii) se kërkesën e tij për masë të sigurisë, parashtruesi i kërkesës e ka bazuar me veprim të inkriminuar. Gjykata Themelore në Prishtinë pas mbajtjes së seancës dëgjimore, ku kishte dëgjuar palët ndërgjygjëse dhe administrimit të provave të bashkëngjitura kishte vendosur që të anulojë masën e sigurisë ndaj paluejtshmërive në emër të E.H. Në Aktvendimin e saj, Gjykata Themelore duke në Prishtinë duke iu referuar paragrafit 1 të nenit 309 dhe paragrafit 2 të nenit 312 të LPK-

së kishte konstatuar se rrethanat në bazë të cilave ishte caktuar masa e sigurisë kishin ndryshuar. Kundër këtij Aktvendimi të Gjykatës Themelore në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, me pretendimin thelbësor se Gjykata Themelore nuk kishte arsyetuar vendimin e saj me faktet dhe kushtet ligjore mbi bazën e të cilave mund të caktohet dhe anulohet masa e caktuar e sigurisë. Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac. Nr. 5974/2020] të 11 dhjetorit 2020 ankesën e parashtruesit të kërkesës e kishte refuzuar si të pabazuar duke e vërtetuar Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

62. Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës e konteston konstatimin e Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor nga kjo gjykatë. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi kërkesës i referohet rastit të Gjykatës KI07/18 [me parashtrues, *Çeliku Rrollers*, Aktgjykim, i 8 dhjetorit 2019] përmes të cilit rast Gjykata kishte afirmuar dhe aplikuar parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ dhe të vet Gjykatës përkitazi me të drejtën për arsyetim të vendimit gjyqësor, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të këtij pretendimi, Gjykata fillimisht (i) do t'i shtjellojë shkurtimisht parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor të vendosura përmes praktikës së GJEDNJ-së dhe të Gjykatës; dhe me pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

63. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj,* Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic,*

Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverbrand*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

64. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring,* paragrafi 44).

65. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-*së Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

66. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit nuk përmbush standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor sepse nuk ka dhënë arsyetim në lidhje me faktet dhe kushtet ligjore mbi bazën e të cilave mund të caktohet e më pas të anulohet vendimi i saj për caktimin e masës së sigurisë.

67. Gjykata Themelore në Prishtinë, si rezultat i kërkesës së E.H, të 4 shtatorit 2019 kishte anuluar vendimin e saj për caktimin e masës së sigurisë duke theksuar se vendimin e saj e mbështet në provat e bashkëngjitura në propozimin për caktimin e masës së sigurisë; provave të bashkëngjitura në kërkesën për anulimin e masës së sigurisë, të parashtruar nga E.H; Aktgjykimin e formës së prerë [PKR. Nr. 23/14] të 16 majit 2016, të Gjykatës Themelore në Gjakovë [përmes të cilit parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor dhe dënuar me burgim në kohëzgjatje prej një viti e gjashtë muaj për kryerjen e veprës penale "të kontraktimit të përfitimit joproporcional", të vërtetuar përmes Aktgjykimit [PAKR. Nr. 421/2016] të 9 shtatorit 2016; dhe deklaratave të palëve ndërgjyqëse gjatë seancës së mbajtur dëgjimore. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore në Prishtinë, pa paragjykim ndaj vendosjes në merita të rastit, duke iu referuar paragrafit 1 të nenit 309 dhe paragrafit 2 të nenit 313 të LPK-së kishte konstatuar se kushtet dhe rrethanat në bazë të të cilave ishte caktuar masa e sigurimit kishin ndryshuar.

68. Parashtruesi i kërkesës i kishte kontestuar konstatimet e Gjykatës Themelore, përmes ankesës në Gjykatën e Apelit duke pretenduar mungesë të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij në thelb kishte theksuar se Aktvendim i Gjykatës Themelore nuk përmban arsyetim të fakteve dhe kushteve ligjore mbi bazën e të cilave mund të anulohet vendimi i saj për caktimin e masës së sigurisë.

69. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. Nr. 5974/2020] të 11 dhjetorit 2020 kishte vlerësuar se Gjykata Themelore në Prishtinë, vendimin e saj e ka bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 16 majit 2016, përmes të cilës ishte shpallur fajtor dhe dënuar për veprën penale të "kontraktimit të përfitimit joproporcional" aktgjykim ky i vërtetuar me Aktgjykimin [PAKR.nr.421/2016] të 9 shtatorit 2016, të Gjykatës së Apelit. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit kishte konstatuar se Gjykata Themelore në Prishtinë drejt ka vendosur kur ka anuluar vendimin e saj për caktimin e masës së sigurisë. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata po ashtu iu ishte referuar paragrafit 1 të nenit 309, dhe paragrafit 2 të nenit 313 të LPK-së, duke theksuar se përmes këtyre dispozitave është paraparë mundësia e gjykatës që të anulojë vendimin e vet për caktimin e masës së sigurisë në rast të ndryshimit të rrethanave për shkak të cilave është caktuar masa e sigurisë.

70. Gjykata gjithashtu ripërsëritë se procedura për caktimin e masës së sigurisë dhe anulimin e saj është përcaktuar me dispozita e LPK-së, përkatësisht me nenet 296-319 të LPK-së. Duke marrë për bazë rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se paragrafi 1 i nenit 309 i LPK-së parasheh mundësinë që të LPK-së parasheh mundësinë që vendimi për caktimin e masës së sigurisë mund të ndryshohet apo anulohet. Përderisa paragrafi 2 i nenit 312 të LPK-së, në mënyrë të qartë përcakton mundësinë e kundërshtarit të sigurimit për të propozuar anulimin e vendimit për caktimin e masës së sigurisë "*po që se rrethanat për shkak të të cilave është caktuar masa e sigurimit, më vonë kanë ndryshuar dhe e kanë bërë të pa nevojshme atë.*"

71. Në rrethanat e rastit konkret, bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se Gjykata Themelore ka mbështetur vendimin e saj si rezultat i ndryshimit të rrethanave në bazë të të cilave paraprakisht kishte vendosur që të aprovojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për caktimin e masës së sigurisë.

72. Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një vendim të arsyetuar gjyqësor e të shtjelluara më lart, rikujton se në adresimin e pretendimeve të parashtruesve përkatës, gjykatat e rregullta, janë të detyruara që të japin përgjigje, ndër të tjera, lidhur me ato pretendime të cilat janë thelbësore ose përcaktuese për rrethanat e një rastit.

73. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se Gjykata e Apelit ka adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura në ankesën e tij përkitazi me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, përmes të cilit ishte anuluar caktimi i masës së sigurisë ndaj paluejtshmërive në emër të E.H.

74. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit nuk karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Për pasojë, pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese në "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*" ashtu siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

75. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij ka përmendur se pretendon shkelje të nenit 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, mirëpo nuk ka shtjelluar dhe arsyetuar fare se si është shkelur kjo e drejtë në rastin e tij. Në kërkesën e tij parashtruesi i kërkesës kërkon që kërkesa e tij të shpallet e pranueshme dhe Gjykata të konstatoj se Aktvendimi i kontestuar [Ac. Nr. 5974/2020] të 11 dhjetorit 2020, i Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [C. Nr. 1710/15] të 23 shtatorit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka shkelur edhe të drejtën e tij të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Për më tepër, Gjykata rikujton se kërkesa e tij për caktimin e masës së sigurisë ndërlidhej me caktimin e sigurisë ndaj paluejtshmërive të E.H.

76. Gjykata, në këtë kontekst thekson se, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, ajo vazhdimisht ka theksuar se: se (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih rastet e Gjykatës KI163/18, parashtrues *Kujtim Lleshi*, i cituar më lart, paragrafi 85, dhe KI124/20 parashtrues *MuhamedAli Ceysűlmedine*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 42).

77. Bazuar në si më sipër, Gjykata konsideron se pretendim i i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, është pretendim "*i pambështetur apo paarsyetuar*", dhe rrjedhimisht, i papranueshëm siç është përcaktuar përmes nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (d) të Rregullores së punës.

78. Prandaj, dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse, pretendimi (i) lidhur me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese në "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*", në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës; ndërsa (ii) lidhur me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është i papranueshëm si "*i pambështetur apo paarsyetuar*" siç është përcaktuar përmes nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 shtator 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin
20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Radomir Laban	Gresa Caka-Nimani

KI100/21, Parashtrues: Moni Commerce Sh.p.k, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP-nr. 72/2020 i 28 tetorit 2020

KI100/21, Aktgjykim i 24 shtator 2021, publikuar më 12 tetor 2021

Fjalët kyqe: person juridik, kodi doganor dhe i akcizave, shkelje e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, vendim i paarsyetuar

Parashtruesi i kërkesës është kompani e cila importon mallra nga "Kompania L", me origjinë nga Kina. Nga shkresat e lëndës rezulton që vlera e këtij malli të deklaruar për zhdoganim nga parashtruesi i kërkesës ishte ri-vlerësuar nga Dogana. Vendimi i Doganës së Kosovës për ri-vlerësim ishte kontestuar nga parashtruesi i kërkesës në shkallë të dytë tek Dogana e Kosovës, e cila vendosi që në rastin konkret, është vepruar drejtë sepse bazuar, mes tjerash, në informatat e marra në zhdogadimet e rregullta dhe çmimet e marra nga berza në kohën e blerjes së mallrave, vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk rezultonte të jetë vlera reale e paguar për mallin me qëllim importi. Për pasojë, parashtruesi i kërkesës kishte filluar procedurat në gjykatat e rregullta, duke kontestuar ligjshmërinë e vendimeve të dy instancave të Doganës së Kosovës. Në vazhdimësi të procedurave në gjykatat e rregullta, Gjykata Themelore, e Apelit dhe Supreme, respektivisht, konstatuan se Dogana e Kosovës ka vepruar drejtë me rastin e vlerësimit të mallit sipas metodës përkatëse të Kodit Doganor dhe Akcizave. Për më tepër, të njëjtat iu referuan edhe faktit që parashtruesi i kërkesës vlerën e deklaruar të mallit lëndor nuk ka mundur ta harmonizoj me vlerën që është paguar me dy transfere bankare, duke theksuar specifikisht që parashtruesi i kërkesës nuk ka vërtetuar përputhshmërinë e vlerës së transaksioneve bankare në shumën prej 7,600.00 USD dhe 5,400.00 USD me vlerën e faturës përcjellëse të mallit që ka vlerën totale prej 22,000.00 USD.

Parashtruesi i kërkesës, si pretendim kryesor para Gjykatës Kushtetuese ka ngritur çështjen e vendimit të mos-arsyetuar gjyqësor, duke pretenduar se Gjykata Supreme nuk ka trajtuar, përkatësisht nuk ka arsyetuar, pretendimin thelbësorë e përcaktues të tij se të gjitha gjykatat më të ulëta kanë lexuar gabimisht faktet e reflektuara në transakcione bankare lidhur me shumën reale të paguar, përkatësisht shumën 15,400.00 USD e kanë shënuar në vendime gjyqësore si 5,400.00 USD, duke rezultuar për pasojë në konstatime të gabuara lidhur me mospërputhjen e shumës së paguar dhe deklaruar.

Në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtave të tij për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata fillimisht shtjellojë dhe më pas aplikoi në rrethanat e rastit konkret, parimet e praktikës së saj gjyqësore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke rikujtuar që bazuar në të

njëjtat, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret, megjithatë është detyrim i të gjithave gjykatave që adresojnë dhe arsyetojnë pretendimet thelbësore dhe përcaktuese të një pale. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, respektivisht, nuk i kishin dhënë përgjigje parashtruesit të kërkesës lidhur me pretendimin kryesor të tij lidhur me çështjen e shumës së reflektuar në transaksionet bankare. Gjykata konsideroi se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është thelbësorë dhe për më tepër, mund të jetë përcaktues lidhur me meritat e padisë së parashtruesit të kërkesës.

Për pasojë dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejtat në proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke e kthyer të njëjtin në rishqyrtim në Gjykatën Supreme.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI100/21

Parashtrues

Moni Commerce Sh.p.k

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP-nr. 72/2020, të 28 tetorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Moni Commerce Sh.p.k me seli në Podujevë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP-nr. 72/2020, të 28 tetorit 2020 në lidhje Aktgjykimin AA.nr. 682/2019 të 10 korrikut 2020 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin A.nr. 1470/17 të 17 prill 2019 të Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative.

3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 26 janar 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 24 maj 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

8. Më 4 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

9. Më 9 qershor 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të bashkëngjisë fletëkthesën qe dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesi Aktvendimin ARJ-UZVP-nr. 72/2020, të 28 tetorit 2020 të Gjykatës Supreme.

10. Më 11 qershor 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë bashkëngjiti fletëkthesën e cila dëshmon se parashtruesi i kërkesës Aktvendimin ARJ-UZVP. 72/2020 të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 26 janar 2021.

11. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

12. Më 24 shtator 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata vendosi me shumicë që (i) kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e pranueshme; (ii) që Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP-nr.72/2020 i 28 tetorit 2020, nuk është në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

13. Parashtruesi i kërkesës, sipas shkresave të lëndës importon çamçakëzë nga "Kompania L", si kompani eksportuese me origjinë nga Kina (në tekstin e mëtejmë "Kompania L").

14. Me 16 qershor 2017 me rastin e deklarimin për doganimin e këtij malli, përmes Deklaratës Unike Doganore (në tekstin e mëtejmë: DUD) me referencë R13844 dhe me rastin e prezantimit të dokumenteve tjera përkatëse, Dogana e Kosovës (Zyra e Pranimit Qendror) në procedurën e zhdoganimit, ka kontestuar vlerën e mallit dhe e kanë ri-vlerësuar atë bazuar në metodën 6 të vlerësimit, duke caktuar vlerë të re doganore, bazuar kjo në bazë të dhënave të Doganës së Kosovës, përkatësisht zhdoganimeve të mëhershme.

15. Më 20 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës parashtron ankesë kundër vendimit R13844 i 16 qershorit 2017, në Sektorin e Ri-shqyrtimit të Vendimeve të Doganës së Kosovës.

16. Më 25 korrik 2017, Dogana e Kosovës përmes Aktvendimit nr. 01.3.2.2/419, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës duke arsyetuar se Zyra e Pranimit Qendror ka vepruar drejtë sepse (i) vlera e mallit të deklaruar për zhdoganim, nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim importi, sepse është deklaruar vlerë më e vogël sesa vlera reale e paguar, në vështrim të nenit 33 të Kodit nr. 03/L-109

Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kodi Doganor dhe i Akcizave); (ii) vlerësimin e mallit e ka bërë duke u bazuar në metodën 6 të vlerësimit të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, ngase informatat e marra në zhdoganimet e rregullta pasqyrojnë vlerën reale të mallrave lëndore kontestuese dhe në rastin konkret si vlerë referencë është marrë çmimi i mallit nga dosja e vlerave, përkatësisht çmimet e marra nga reuters si çmime të berzës në kohën e blerjes së mallrave. Më tej, Dogana e Kosovës theksoi se kontrata e prezantuar nga subjekti në procedurë, nuk është nënshkruar dhe vulosur nga palët, dhe e njëjta nuk dallon nga proforma e faturës, përveç ndryshimit "Proforma Invoice" në "Contract", prandaj e njëjta nuk është dokument i besueshëm. Lidhur me aplikimin e nenit 33 të Kodit Doganor dhe Akcizave, Dogana e Kosovës arsyetoi se subjekti duhet të dëshmoj që vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit dhe ndryshe nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës tregojnë çmimet e zhdoganimeve të mëhershme.

17. Më 25 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi kundër Aktvendimit nr. 01.3.2.2/419, të 25 korrikut 2017 të Doganës së Kosovës, duke theksuar se me rastin e doganimit të mallit parashtruesi i kërkesës ka poseduar dhe prezantuar zyrtarëve doganor të gjitha dokumentet obligative për deklarimin e mallit. Parashtruesi i kërkesës pretendoi (i) shkelje të dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave sepse nuk është zbatuar neni 33 i këtij Kodi, edhe pse janë prezantuar dokumentet përkatëse; (ii) shkelje e Udhëzimit Administrativ 11/2009 përkatësisht neneve 60-68 dhe 123 sepse nuk është bërë verifikimi i dhe pranimi i dokumenteve; (iii) vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike për shkak të mënyrës se si është përcaktuar vlera e mallit; (iv) shkelje e dispozitave të procedurës administrative sepse sipas tij zyrtaret doganor pranë Doganës së Kosovës nuk kanë vepruar në mënyre objektive me rastin e kontestimit te vlerës se këtij malli, duke mos i dhëne peshën e duhur fakteve që janë prezantuar me rastin e deklarimit; (v) zbatim i gabuar i së drejtës materiale përkatësisht i nenit 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave.

18. Më 17 prill 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit A.nr. 1470/17 refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, dhe la në fuqi Aktvendimin nr. 01.3.2.2/419 të 25 korrikut 2017 të Doganës së Kosovës. Gjykata Themelore së pari theksoi se (i) është vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të malli është bazuar në metodën 6 të vlerësimit të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, në bazë të dhënave të marra nga Dogana e Kosovës sepse këto të dhëna janë marrë nga zhdoganimet e

rregullta nëpër degë, dhe si vlerë referencë është marrë çmimet e marra nga reuters si çmime të berzës në kohën e blerjes së mallrave DUD-i R13880/2016; (ii) dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme kjo sepse qe kontrata e prezantuar nga parashtruesi i kërkesës nuk është e nënshkruar dhe vulosur nga ana e palëve dhe e cila nuk dallonte për asnjë shkronje nga proforma e faturës. Së dyti, Gjykata Themelore arsyetoi se nga provat e administruara (i) nuk kontestohet fakti që transaksionet bankare të paraqitura në shkresat e lëndës përfitues i mjeteve është subjekti "Kompania L" në Kinë, por vlerën e këtyre transaksioneve Gjykata Themelore nuk ka mundur ta harmonizoj me vlerën e deklaruar të mallit sipas faturës përcjellëse të mallit të deklaruar me DUD R13844/ të 16 qershorit 2017 në ZBK Merdare; (ii) Gjykata nuk ka mund të bëjë harmonizimin e vlerës së deklaruar të mallit lëndor me vlerën e paguar të transaksionit te prezantuar sipas transfereve bankare të 09 marsit 2017 dhe 06 qershorit 2017 në TEB Bank dhe parashtruesi në padinë e tij dhe në seancën gjyqësore nuk ka sqaruar pse vlera e këtyre transaksioneve bankare në shumë prej 7,600USD dhe 5,400 USD, nuk harmonizohen me vlerën e faturës përcjellëse te mallit doganor nr. SHX/MONI01 të 20 prillit 2017 qe ka vlerën totale prej 22,000USD, dhe Kontratës 24 shkurtit 2017 që ka të njëjtën vlerë. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore theksoi se meqenëse nga provat e administruara nuk ka mundur të konstatoi se parashtruesi i kërkesës i ka paguar "Kompanisë L" vlerën reale të mallit lëndor, atëherë Dogana e Kosovës ka vepruar drejtë kur ka aplikuar metodën e 6 të vlerësimit sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe Akcizave.

19. Gjithashtu, Gjykata Themelore theksoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar se vlera e mallit lëndor është e përafërt me vlerën e mallrave identike apo të ngjashme të shitura për eksport ne Kosovë, te paraqitura në të njëjtën kohë, që në ketë rast do të aplikohej dispozita e nenit 34 paragrafi 2 pika (a) dhe (b) të Kodit Doganor dhe te Akcizave, dhe parashtruesi nuk ka arritur të dëshmoi vlerën e transaksionit, andaj nuk mund të pranohet pretendimet se dokumentacioni përcjellës është në përputhje me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave (në tekstin e mëtejmë Udhëzimi Administrativ 11/2009).

20. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit A.nr. 1470/17 të Gjykatës Themelore, duke konsideruar se i njëjti është përfshirë në (i) shkeljes esenciale te dispozitave të procedurës duke theksuar se pasi qe ka vlerësuar dhe çmuar vetëm provat e parashtruara nga e parashtruesi i kërkesës dhe nuk e ka detyruar Doganën e Kosovës për vërtetimin e fakteve dhe

mbështetjen e vendimit të atakuar të kësaj të fundit, dhe për më tepër, Gjykata Themelore ka bërë gabim gjatë llogaritjes së pagesave nga urdhërpagesat bankare; (ii) vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sepse sipas tij gjykata e shkallës së parë ka gabuar me rastin e leximit të përmbajtjes së transferit bankar të 6 qershorit 2017 pasi ka konsideruar se shuma e paguar është **5,400 USD,** mirëpo nga shkresat e lëndës shihet që është **15, 400 USD,** dhe potencon se vlera shënuar në faturën SHX/MONI01 të 24 shkurtit 2017 është 22,000.00 USD dhe pagesa prej 1,000.00 USD në emër të etiketave të produkteve lëndore dhe e cila nuk hyn në bazë doganore, dhe që të dyja urdhërpagesat në shumë prej 23,000.00 USD janë paguar në emër të faturës lëndore që është në harmoni me vlerat e pagesave me këtë faturë; (iii) aplikim të gabuar të së drejtës materiale kur është aplikuar neni 35 i Kodit Doganor dhe i Akcizave dhe është dashur të zbatohej neni 33 i tij. Poashtu, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009.

21. Më 10 korrik 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit AA.nr. 682/2019 refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin A.nr. 1470/17 të Gjykatës Themelore, duke pranuar qëndrimin juridik të kësaj të fundit si të bazuar. Sa i përket pretendimeve për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, Gjykata e Apelit vlerësoi se nuk qëndron sepse janë respektuar hapat sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ (në tekstin e mëtejmë: LKA) dhe Kodit Doganor dhe të Akcizave. Më pas, sa i përket pretendimeve lidhur me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit konsideroi se Gjykata Themelore ka nxjerrë prova të mjaftueshme që vërtetojnë se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë të pabazuara dhe theksoi se nuk mund të vërtetojë një gjendje tjetër faktike nga gjendja që ka konstatuar Dogana e Kosovës. Gjykata e Apelit, i referohet çështjes së mos-harmonizimit të vlerës së deklaruar të mallit lëndor të paguar me transaksionin të 09 marsit 2017 dhe 06 qershorit 2017 në TEB Bank dhe faktit që të njëjtat në shumë prej 7600 USD dhe 5400 USD nuk harmonizohen me vlerën e faturës përcjellëse të mallit doganor nr. SHX/MONI01 të 20 prillit 2017 në vlerën totale prej 22.000 USD dhe kontratës me njëjtën vlerë. Për këtë arsyetim, Gjykata e Apelit u bazuar në nenin 35 dhe nenit 34 paragrafi 2 pika (a) dhe (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Së dyti, sa i përket vlerës prej 22.000 USD dhe 1.000 USD për vendosjen e tiketave, Gjykata e Apelit të njëjtat nuk i aprovoi sepse sipas saj parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë në gjendje të dëshmojë vlerën e transaksionit të paguar për mallin lëndor, andaj nuk mund të pranohen pretendimet se dokumentacioni është dorëzuar konform nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009.

22. Më 29 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës theksoi se Gjykata e Apelit nuk i ka vërtetuar faktet dhe provat në të cilat e ka mbështetur rivlerësimin fillimisht Dogana e Kosovës, e pastaj edhe dokumentet me te cilat ka pretenduar të mbështes vendimin e saj në procedurë të ankeses tek Dogana e Kosovës dhe në procedurë të konfliktit tek gjykata. Parashtruesi theksoi se fillimisht Gjykata Themelore ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike në kuptim të tyre duke e cilësuar si dokumente te pa mjaftueshme, me arsyetimin se pagesat bankare qe janë bërë në emër te faturës se mallrave lëndore nuk përputhen me vlerën e faturës. Por thekson se nga paragrafi 6, i faqes së 2-të të arsyetimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore është evidentuar në mënyre të gabuar vlera e transferit bankar e 6 qershorit 2017, duke konstatuar në mënyrë të gabuar vlerën e tij prej **5,400 USD,** në vend të shumës reale **15,400 USD.** Lidhur me këtë pikë, parashtruesi i kërkesës thekson se (i) vlera mallit të deklaruar me DUD R-13844 të 16 qershorit 2017, është shënuar edhe në faturën SHX/MONI01 të 24 shkurtit 2017, dhe atë shuma prej 22,000 USD, dhe po në këtë faturë është shtuar vlera e mallit prej 1,000 USD për shkak vendosjes së etiketave në produkte. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës thekson se ai ka paguar me 9 mars 2017 shumën prej 7,600 USD, ndërsa me 6 qershor 2017 shumën prej 15,400 USD dhe të dy urdhërpagesat formojnë shumën prej 23,000 USD. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konsideron se është i paqëndrueshëm konstatimi i Gjykatës Themelore se parashtruesi i kërkesës nuk ka mundur të bëjë harmonizimin e pagesave bankare dhe faturave. Në fund sa i përket çështjes së pagesës së 1,000 USD, të paguar në emër të tiketave, parashtruesi i kërkesës e konsideron se e njëjta nuk hyn në bazë doganore për llogaritjen e detyrimeve të importit andaj thekson se Gjykata e Apelit nuk ka aplikuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009.

23. Më 28 tetor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit ARJ- UZVP-nr.72/2020, refuzoi si të pabazuar kërkesës e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm. Gjykata Supreme theksoi se gjykatat e instancave më të ulëta, kanë konstatuar drejtë se në shkresat e lëndës nuk ka mundur të gjendet asnjë provë e cila do vërtetonte se parashtruesi i kërkesës ka paguar vlerën reale të transaksionit të mallit të importuar siç parashihet me nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor nuk është në pajtim me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009. Gjykata Supreme i sqaroi parashtruesit se për t'u pranuar vlera e mallit sipas

nenit 34 paragrafi 2 pika (a) dhe (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave, parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmoj se vlera e mallit lëndor është e përafërt me vlerën e mallit identik apo të ngjashëm të shitur për eksport në Kosovë dhe poashtu theksoi se gjykata nuk ka mundur të bëjë harmonizimin e vlerës së deklaruar të mallit lëndor me vlerën e paguar të transaksionit të transfereve bankare me 9 mars 2017 shumën prej 7,600 USD, ndërsa me 6 qershor 2017 shumën prej 5,400 USD dhe pse vlera e këtyre transaksioneve nuk harmonizohet me faturën përcjellëse SHX/MONI01 të 20 prillit 2017 në vlerë prej 22,000 USD. Në fund, Gjykata Supreme theksoi se: (i) nuk ka mundur të pranoj pretendimin nga padia se vlera e deklaruar e mallit paraqet vlerën e saj reale; (ii) pranon konstatimet e Doganës së Kosovës se parashtruesi i kërkesës nuk ka prezantuar dokumentacionin e kompletuar me të cilin do vërtetohej se çmimi i deklaruar është njëherit vlera reale e mallit sipas nenit 34 paragrafi 2 pika (a) dhe (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave; (iii) meqë nuk është vërtetuar se a i ka paguar "Kompanisë L" parashtruesi i kërkesës vlerën reale në bazë të faturave, atëherë Dogana e Kosovës ka vepruar me të drejtë lidhur me vlerësimin e ri të mallit lëndor dhe aplikimin e metodës 6 të parashikuar me nenin 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimit të kontestuar, atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

25. Parashtruesi i kërkesës fillimisht pohon se me rastin e deklarimit të mallit për importim, ai ka prezantuar të gjitha dokumentet obligative për të bërë bindëse vlerën reale të mallit, dhe këto dokumente nuk janë marrë parasysh pranë zyrtarëve të Doganës së Kosovës, të cilët kanë kontestuar vlerën e mallit dhe e kanë ri-vlerësuar atë.

26. Parashtruesi i kërkesës, më tej pohon se Gjykata Themelore ka gabuar me rastin e leximit të përmbajtjes së transferit sepse në fakt transferi bankar i datës 6 qershor 2017 është 15, 400 USD e jo 5, 400 USD, dhe ky gabim është përcjellë edhe në dy instancat tjera gjyqësore, andaj sipas parashtruesit të kërkesës është i paqëndrueshëm konstatimi se ai nuk ka mundur të bëjë harmonizimin e pagesave bankare dhe faturave.

27. Rrjedhimisht, duke u bazuar në nenin 31 të Kushtetutës parashtruesi i kërkesës thekson se konteston konstatimet e Gjykatës Supreme, duke

potencuar se transaksioni bankar me vlerë prej 15,400.00 USD është lexuar si 5,400.00 dhe kjo nuk paraqet vlerësim te gabuar te provës dhe të gjendjes faktike, por paaftësi i gjyqtarit për të parë përmbajtjen e sakte të këtij dokumenti, prandaj konsideron se kjo konsiston në proces të parregullt gjyqësor. Parashtruesi thekson se ai në tri instancat gjyqësore ka theksuar se është lexuar gabimisht përmbajtja e transferit bankar.

28. Parashtruesi i kërkesës konsideron se përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me mungesën e dokumentacionit financiar për të vërtetuar çmimin e mallit, Gjykata Supreme ka miratuar qëndrimin e instancave më të ulëta përkundër faktit se transferet bankare vërtetojnë përputhjen me faturën dhe vërtetojnë çmimin e mallit.

29. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka dhënë vendim të arsyetuar përkatësisht ajo (i) nuk ka dhënë arsyetim për vendimin e saj; (ii) bazuar në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriu (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), gjykatat kërkohet që t'i shqyrtojnë argumentet thelbësore të palës; dhe se (iii) heshtja e gjykatave përkitazi me pretendime me rëndësi të parashtruesve të kërkesës mund të përdoret si refuzim.

30. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës, pretendon se Gjykata Supreme është nxjerrë duke shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për vendim të arsyetuar gjyqësor sepse e njëjta ka dështuar të adresojë pretendimet thelbësore të parashtruesit rreth shkeljes së ligjit të aplikueshëm përkatësisht nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, lidhur me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ.

31. Parashtruesi i kërkesës, më konkretisht thekson Gjykata, Supreme nuk ka sqaruar se pse vlera e këtyre transaksioneve bankare në shumë prej 7,600.00 dhe 5.400.00 USD nuk harmonizohen me vlerën e faturës përcjellëse te mallit doganor nr. SHX/MONI01 të 20 prillit 2017 me vlerën totale të faturës 22,000.00 USD dhe Kontratës të 24 shkurtit 2017 që ka të njëjtën vlerë. Mirëpo me ketë rast nuk ka arsyetim lidhur me pretendimin e parashtruesit te kërkesës se fatura realisht ka vlerë malli 22,000.00 USD dhe 1,000.00 USD për etiketimin e mallit gjithsejtë 23,000.00 USD, e cila është paguar me anë të dy transfereve bankare njërit në vlerë prej 7,400.00 USD dhe tjetrit 15,400.00 e jo 5,400.00, sipas pretendimit siç është lexuar nga të gjithë gjyqtaret deri tani, e lexuar në mënyrë të pasaktë.

32. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se pretendon dhe shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sepse nuk është mbajtur seancë e shqyrtimit me rastin e shqyrtimit të ankesës, dhe

shkeljen e tillë nuk e ka vërejtur Gjykata Supreme e cila kujdeset sipas detyrës zyrtare.

33. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të (i) deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje te nenit 31 te Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme ARJ-UZVP-nr. 72/2020 të 28 tetorit 2020; Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.nr. 682/2019, të 10 korrikut 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore A.nr. 1470/17, të 17 prillit 2019, si dhe të kthejë lëndën në ri-shqyrtim.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2.Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

3. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit

publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

KODI Nr. 03/L-109 DOGANOR DHE I AKCIZAVE NË KOSOVË

Neni 33

1. Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37, me kusht që:

a) Nuk ekzistojnë kufizime për disponimin ose shfrytëzimin e mallrave nga blerësi, përveç atyre kufizimeve të cilat:

- Janë vendosur ose kërkohen me ligj prej autoriteteve publike në Kosovë,

- Kufizojnë hapësirën gjeografike në të cilën mallrat mund të rishiten ose

- Kryesisht nuk ndikojnë në vlerën e mallrave;

b) Shitja ose çmimi nuk janë objekt i disa kushteve apo shqyrtimeve të mëvonshme për shkak të të cilave nuk mund të caktohet vlera lidhur me mallrat që vlerësohen;

c) Asnjë pjesë e të ardhurave të nxjerra nga çdo rishitje, posedim ose përdorim të mëvonshëm të mallrave nga blerësi nuk i kthehet drejtpërdrejt ose tërthorazi shitësit, përveç rastit kur mund të bëhet një përshtatje e nevojshme në përputhje me nenin 36, dhe

d) Blerësi dhe shitësi nuk janë në lidhje ose kur blerësi dhe shitësi janë në lidhje, vlera e transaksionit do të jetë e pranueshme për qëllime doganore sipas paragrafit 2.

2. Për qëllime të paragrafit 1, vlen me sa vijon:

a) Për të përcaktuar nëse vlera e transaksionit është e pranueshme, fakti që blerësi dhe shitësi janë në lidhje, nuk paraqet vetvetiu një arsye të mjaftueshme për të konsideruar vlerën e transaksionit si të

papranueshme. Sipas nevojës, shqyrtohen rrethanat e shitjes dhe pranohet vlera e transaksionit, me kusht që lidhja ndërmjet tyre të mos ketë ndikuar në çmim. Nëse, në bazën e të dhënave të ofruara nga deklaruesi ose të marra nga burimet e tjera, dogana ka arsye të dyshojë se kjo lidhje ka ndikuar në çmim, ajo, ia komunikon arsyet deklaruesit, të cilit i jepet një mundësi për t'u përgjigjur. Me kërkesë të deklaruesit, arsyet i komunikohen me shkrim.

b) Në një shitje ndërmjet personash në lidhje, vlera e transaksionit pranohet dhe mallrat vlerësohen në përputhje me paragrafin 1, kur deklaruesi provon që kjo vlerë është e përafërt me njërën nga vlerat e mëposhtme, që paraqiten në të njëjtën kohë apo përafërsisht në të njëjtën kohë:

(i) vlerës së transaksionit të mallrave identike ose të ngjashme të shitura për eksport në Kosovë ndërmjet blerësve dhe shitësve që nuk janë në lidhje;

(ii) vlerës doganore të mallrave identike ose të ngjashme, siç përcaktohet me nenin 34 (2) (c);

(iii) vlerën doganore të mallrave identike ose të ngjashme, siç përcaktohet nën nenin 34 (2) (d).

Në zbatimin e kritereve të sipër përmendura, duhet pasur parasysh dallimet që shfaqen me nivelet komerciale, nivelet sasiore, elementet e numëruara në nenin 36 dhe shpenzimet të cilat i bartë shitësi për atë shitblerje, ku shitësi dhe blerësi nuk janë në lidhje dhe kur ato shpenzime nuk janë të bartura nga shitësi në shitblerje në të cilën blerësi dhe shitësi janë në lidhje.

c) Kriteret e vendosura në nën-paragrafin (b) përdoren me kërkesë të deklaruesit dhe vetëm për qëllime krahasimi. Nuk mund të vendosen vlera zëvendësuese sipas nën-paragrafit në fjalë.

3. Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë.

Veprimtaritë, duke përfshirë veprimtaritë e marketingut, të ndërmarra nga blerësi në llogari të vet, të tjera nga ato për të cilat janë përmendur me nenin 36, që parashikojnë një përshtatje, nuk konsiderohen se janë një pagesë e tërthortë, që i bëhet shitësit, edhe pse mund të konsiderohen se janë në dobi të shitësit ose janë ndërmarrë në marrëveshje me shitësin dhe kostoja e tyre nuk do t'i shtohet çmimit vërtetë të paguar ose të pagueshëm gjatë përcaktimit të vlerës doganore të mallrave të importuara.

Neni 34

1. Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit;

Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij.

2. Vlera doganore e përcaktuar sipas këtij neni do të jetë:

a) Vlera e transaksionit të mallrave identike të shitura për eksport për Kosovë dhe të eksportuara në te njëjtën kohë, ose përafërsisht, në të njëjtën kohë me mallrat që janë duke u vlerësuar;

b) Vlera e transaksionit të mallrave të ngjashme të shitura për eksport për Kosovë dhe të eksportuara në të njëjtën kohë ose përafërsisht në të njëjtën kohë me mallrat qe janë duke u vlerësuar;

c) Vlera e bazuar në çmimin për njësi, në të cilin mallrat e importuara që korrespondojnë me mallrat identike ose të ngjashme të importuara dhe të shitura brenda Kosovës, në sasi të përgjithshme më të madhe, personave qe nuk janë në lidhje me shitësin;

d) Vlera e llogaritur përbëhet nga shuma e:

- Kostos apo vlerës së materialeve dhe fabrikimit apo përpunimit tjetër për prodhimin e mallrave të importuara,

- Shumës së fitimit dhe të shpenzimeve të përgjithshme, që ka bërë prodhuesi në vendin e eksportit për t'i eksportuar në drejtim të Kosovës, të barabarta me shumat që zakonisht reflektohen në shitjen e mallrave të së njëjtës kategori apo të e njëjtit lloj me mallrat të cilat po vlerësohen,

- Kostos ose vlerës së elementeve të përmendur në nenin 36 (1) (e).

3. Rregullat apo kushtet e mëtutjeshme për zbatimin e paragrafit 2 të këtij neni do të përcaktohen në Udhëzimin Administrativ për zbatimin e këtij Kodi.

Neni 35

1. Kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 ose 34, do të përcaktohet në bazën e të dhënave të disponueshme në Kosovë, duke përdorë metoda të arsyeshme në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme:

- Marrëveshjen për implementimin e Nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994;.

- Nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994;

- Dispozitave të këtij kreu.

2. Në rastet kur zbatohet paragrafi 1 asnjë vlerë doganore nuk mund të përcaktohet mbi bazën e:

a) Çmimit të shitjes së mallrave të prodhuara në Kosovë;

b) Një sistemi i cili për qëllime doganore parashikon pranimin e vlerës më të lartë midis dy vlerave alternative;

c) Çmimit të mallrave në tregun vendor të vendit eksportues;

d) Kostos së ndryshme të prodhimit nga vlerat e përllogaritura që janë përcaktuar për mallra identike apo të ngjashme në përputhje me nenin 33 (2) (d);

e) Çmimeve për eksport në një vend tjetër nga ai i Kosovës;

f) Vlerave doganore minimale ose

g) Vlerave arbitrare ose fiktive.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr.11/2009, PËR IMPLEMENTIMIN E KODIT TË DOGANAVE DHE AKCIZES

KREU IV
VLERA DOGANORE
KAPITULLI 1

Dispozitat e përgjithshme
Neni 60

1. Në aplikimin e dispozitave të nenit 32 deri 35 të Kodit Doganor dhe Akcizës, si dhe atyre në këtë kreu, Dogana e Kosovës duhet të përputhen me dispozitat e paraqitura në Aneksin 12. Dispozitat e paraqitura në kolonën e parë të Aneksit 12, duhet të aplikohen në kuptim të shënimit interpretues që shfaqet në kolonën e dytë.
2. Nëse është e domosdoshme për t'u referuar në parimet e përgjithshme të pranuara të mbajtjes së llogarisë në përcaktimin e vlerës doganore, atëherë duhet të aplikohen dispozitat e Aneksit 13.

Neni 61

1. Për qëllimet e këtij kreu:
a) „Marrëveshje" nënkupton Marrëveshjen për Implementimin e Nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë e arritur në kornizën e negociatave multilaterale të tregtisë të vitit 1973 deri 1979 dhe të referuara të fillim të Seksionit 3 5.1 të Kodit;
b) „Mallrat e prodhuara" përfshijnë mallrat e kultivuara, prodhuara dhe të nxjerra nga nëntoka ose burimet minerale;
c) „mallrat identike" nënkuptojnë mallra të prodhuara në të njëjtin vend, të cilat janë identike në çdo pikëpamje, duke përfshirë edhe karakteristikat fizike, cilësinë dhe reputacionin. Ndryshime të vogla në pamje nuk përbëjnë shkak për t'u konsideruar jo identik.
d) „mallrat e ngjashme" nënkuptojnë mallrat e prodhuara në të njëjtin vend, të cilat edhe pse nuk janë të njëjta në të gjitha aspektet, kanë karakteristika të ngjashme dhe komponentë materialesh të ngjashme, që mundëson që ato të kryejnë të njëjtat funksione dhe që nga pikëpamja komerciale të jenë të pandryshueshme; Kualiteti i mallrave, pamja e tyre dhe ekzistenca e shenjës

mbrojtëse janë në mes tjerash faktorëtpër t'u konsideruar në përcaktimin nëse mallrat janë të ngjashme;
e) „mallrat e klasës apo llojit të njëjtë" nënkupton mallrat që kualifikohen në kuadër të grupit apo rangut të mallrave të prodhuara nga industria e veçantë apo sektorit industrial, duke përfshirë mallrat identike apo të ngjashme.
2. „mallrat identike dhe mallrat e ngjashme", sipas rastit nuk zbatohen për mallra, të cilat inkorporohen apo paraqesin punim inxhinierik, zhvillimi, punë artistike, projektuese, si dhe vizatime dhe skica, për të cilat nuk është bërë ndonjë rregullim sipas neni 36.1 (b) (iv) të Kodit, sepse elementet e tilla janë ndërmarrë në Kosovë.

Neni 62

1. Për qëllimet e Kreut II, Kapitulli 3 i Kodit dhe i këtij Kreu, personat duhet të konsiderohen të jenë në lidhje vetëm, nëse:
a) Ata janë zyrtarë apo drejtorë të bizneseve të tjerëve;
b) Ata sipas ligjit njihen si partner në biznes;
c) Ata janë punëdhënës dhe punëtor;
d) Ndonjë person i cili direkt apo indirekt ka pronësi, kontrollon apo mban 5% apo
më shumë të fuqisë votuese nga rezervat apo aksionet e të dyve;
e) Njëri nga ta direkt apo indirekt kontrollon tjetrin;
f) Të dy ata direkt apo indirekt kontrollohen nga personi i tretë;
g) Ata së bashku direkt apo indirekt kontrollojnë personin e tretë, apo
h) Ata janë anëtarë të njëjtës familje. Personat duhet të konsiderohen si anëtarë të së njëjtës familje, vetëm nëse ata qëndrojnë në ndonjërin nga lidhjet e dhëna në vazhdim për njëri tjetrin:
[...]

2. Për qëllimet e këtij kreu, persona që janë të bashkuar në biznes me njëri-tjetrin, për shkak se njëri prej tyre është i vetmi agjent, shpërndarës, ose koncesionar i tjetrit, sido që të jetë emërtimi, do të konsiderohen në lidhje, vetëm në qoftë se hyjnë në njërën prej marrëdhënieve të paragrafit 1.

Neni 63

Për të përcaktuar vlerën doganore të mallrave sipas nenit 33 të Kodit, malli për të cilin çmimi nuk është paguar në kohën e paraparë për caktimin e vlerës për qëllime doganore, çmimi i cili duhet të paguhet për ta shlyer obligimin në kohën e përcaktuar, sipas rregullit merret si bazë për vlerë doganore.

Neni 64

1. Kur mallrat e deklaruara për qarkullim të lirë janë pjesë e një sasie më të madhe mallrash të njëjtë, të blera në një transaksion të vetëm, çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar, sipas nenit 33.1 të Kodit, do të jetë çmimi i paraqitur në mënyrë proporcionale të çmimit të përgjithshëm të paraqitur për mallin që ka sasinë e përgjithshme të mallit të blerë.

Ndarja e çmimit të paguar apo të pagueshëm mundet gjithashtu të aplikohet në rastin e humbjes së pjesës së dërgesës apo kur mallrat që janë duke u vlerësuar, janë dëmtuar para lëshimit në qarkullim të lirë.

2. Pas lëshimit të mallit në qarkullim të lirë, harmonizimi i çmimit i cili realisht është paguar apo i pagueshëm për mallin, ku shitësi e ekzekuton për blerësin, mund të merret parasysh për caktimin e vlerës doganore në përputhje me nenin 33 të Kodit, nëse doganës ia dëshmon se;

a) Mallrat janë të dëmtuara në momentin e paraparë sipas Seksionit 71 të Kodit;

b) Shitësi ka bërë rregullimin (ndërrimin) në ekzekutimin e obligimeve të garantues të paraparë në kontratën për shitblerje, e cila është lidhur para lëshimit të mallit në qarkullim të lirë;

c) Mangësitë e mallit nuk janë marrë parasysh në kontratën relevante të shitblerjes.

3. Çmimi i paguar apo i pagueshëm për mallrat i përshtatur në përputhje me Paragrafin 2, mund të merret parasysh vetëm nëse përshtatja është bërë brenda periodës prej 12 muajsh nga data e pranimit të deklaratës për lëshim në qarkullim të lirë të mallrave.

Neni 65

Kur çmimi i paguar apo i pagueshëm për qëllimet e nenit 33.1 të Kodit përfshinë shumën (vlerën) në lidhje me tatimin e brendshme të aplikueshme brenda vendit të origjinës apo 42 eksportit në lidhje me mallrat konkrete, shuma e dhënë nuk hyn në vlerën doganore me kusht që të mund të dëshmohet para Doganës, qe malli konkret është i liruara apo do të jetë nga ky tatim në dobi të blerësit.

Neni 66

1. Për qëllimet e nenit 33 të Kodit, fakti që malli që është objekt i shitjes i paraqitur për qarkullim të lirë konsiderohet si tregues

adekuat se ato janë shitur për eksport në Kosovë. Në rast të shitjeve suksesive para vlerësimit, vetëm shitja e fundit e cila ka sjell deri te hyrja e mallrave në Kosovë apo shitja, e cila bëhet në Kosovë para lëshimit të mallit në qarkullim të lirë, duhet përbërë një tregues të tillë.

Kur çmimi i deklaruar ka të bëjë me shitjen e kryer para shitjes së fundit mbi bazat e të cilit mallrat janë futur në Kosovë, atëherë duhet të dëshmohet para Doganës. Se kjo shitje e mallrave është bërë për eksport në Kosovë. Dispozitat e nenit 88 deri 92 aplikohen:

2. Kur mallrat janë përdorur në ndonjë vend tjetër ndërmjet kohës së shitjes dhe kohës së hyrjes në qarkullim të lirë, vlera doganore nuk duhet të jetë vlera e transaksionit.

3. Blerësi nuk ka nevojë të plotësojë asnjë kusht tjetër nga ajo që ka qenë pjesë e kontratës së shitjes.

Neni 67

Kur në aplikimin e nenit 33.1 (b) të Kodit, konstatohet se shitja apo çmimi i mallrave të importuara i nënshtrohet ndonjë kushti apo kompensimi vlera, vlera e të cilit përcaktohet, kjo vlerë konsiderohet pagesë indirekte e blerësit për shitësin dhe pjesën e çmimit të paguar apo të pagueshëm, nëse kushtet apo më pas nuk ka të bëjë me:

a) Aktivitetin për të cilin aplikohet neni 33.3 (b) i Kodit; apo

c) Faktorë të cilët duhet shtuar çmimit të paguar apo të pagueshëm sipas dispozitave të nenit 36.1 deri në 36.5 të Kodit.

Neni 68

1. Për qëllimet e nenit 33.3 (b) të Kodit, termi "aktivitetet e marketingut" nënkuptojnë të gjitha aktivitetet në lidhje me reklamimin dhe promovimin e shitjes së mallrave dhe të gjitha aktivitetet në lidhje me të drejtat apo garancionet në lidhje me to.

2. Aktivitetet e tilla të ndërmarra nga blerësi duhet të konsiderohen se janë ndërmarrë në llogarinë e vet, edhe nëse ato janë kryer në përputhje me obligimin e marr të blerësit, duke pasuar marrëveshjen me shitësin.

[...]

Neni 91

Personi i referuar në Nenin 88 (2) të këtij akti, duhet të paraqes doganës kopjen e faturës mbi bazë të së cilës e paraqet vlerën e

mallit të importuar. Kur vlera doganore është deklaruar me shkrim, Dogana do të mbajë atë kopje.

Dokumentet që duhet bashkangjitur deklaratës doganore
Neni 123

1. Dokumentet ne vijim duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë:

a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti;
b) Kur kërkohet sipas Nenit 88 të këtij akti, deklarata për vlerat doganore të mallrave të deklaruara i bëjnë në përputhje me kushtet e paraqitura në nenin e dhënë;
c) Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruara;
d) Të gjitha dokumentet e tjera të kërkuara për aplikimin e dispozitave që rregullojnë lirimin për qarkullim të lirë të mallrave të deklaruara.

2. Dogana mund të kërkojë që në momentin e paraqitjes së deklaratës të parashtrojë edhe dokumentet e transportit ose kur është rasti, paraqitjen e dokumenteve që lidhen me procedurën doganor të mëparshëm. Kur një artikull i vetëm paraqitet në dy ose më shumë paketime, dogana mund të kërkojë edhe paraqitjen e një liste paketimi ose të një dokumenti të barazvlefshëm që tregon përmbajtjen e secilës prej paketimeve.

3. Kur malli i plotëson kushtet për lirim nga detyrimet importuese doganore, dokumentet e përmendura në paragrafin 1 (a), (b) dhe (c) nuk duhet të kërkohen, përveç nëse dogana e konsideron të nevojshme për qëllim të zbatimit të dispozitave që rregullojnë vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë.

LIGJI Nr. 04/L-102 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT Nr. 03/L-222

Neni 81.G
Seanca e shqyrtimit

1. Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore dhe Gjykata e Apelit duhet të mbajnë seanca publike ku palët dëgjohen dhe provat shqyrtohen.
2. Gjykata mund të mbaj seanca të mbyllura, kur ekzistojnë arsye të duhura në lidhje me sigurinë dhe çështjet konfidenciale të përfshira.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

34. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> [...]
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

36. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".*

37. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.,* Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe shih rastin KI26/19, parashtrues *Xhavit Thaqi Pronar i kompanisë "NTP INTERBAJ",* Aktvendim për papranueshmëri i 7 tetorit 2020, paragrafi 56).

38. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

39. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP-nr. 72/2020, të 28 tetorit 2020, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

40. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

41. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës si kompani importuese ka deklaruar për zhdoganim mallin nga "Kompania L" përmes DUD përkatëse. Vlera e mallit e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës në ZBD Merdare, është kontestuar nga Dogana e Kosovës e cila ka ri-vlerësuar vlerën e mallit bazuar në metodën 6 të vlerësimit sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Ky vendim, është atakuar nga parashtruesi i kërkesës në shkallë të dytë tek Dogana e Kosovës, e cila theksoi se Zyra e Pranimit Qendror ka vepruar drejtë sepse (i) vlera e mallit të deklaruar për zhdoganim, nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim importi, sepse është deklaruar vlerë më e vogël sesa vlera reale e paguar, në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të (ii) vlerësimin e mallit e ka bërë duke u bazuar në metodën 6 të vlerësimit të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, ngase informatat e marra në zhdoganimet e rregullta pasqyrojnë vlerën reale të mallrave lëndore kontestuese dhe në rastin konkret si vlerë referencë është marrë çmimi i mallit nga dosja e vlerave, përkatësisht çmimet e marra nga reuters si çmime të berzës në kohën e blerjes së mallrave. Më tej, Dogana e Kosovës theksoi kontrata e prezantuar nga subjekti në procedurë, nuk është nënshkruar dhe vulosur nga palët, dhe e njëjta nuk dallon nga proforma e faturës, përveç ndryshimit "Proforma Invoice" në "Contract", prandaj e njëjta nuk është dokument i besueshëm.

42. Parashtruesi i kërkesës u ankua në gjykatat e rregullta, ku fillimisht Gjykata Themelore, theksoi se (i) është vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të malli është bazuar në metodën 6 të vlerësimit të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, në bazë të dhënave të marra nga Dogana e Kosovës sepse këto të dhëna janë marrë nga zhdoganimet e rregullta nëpër degë, dhe si vlerë referencë është marrë çmimet e marra nga reuters si çmime të berzës në kohën e blerjes së mallrave DUD-i R13880/2016; (ii) dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme kjo sepse qe kontrata e prezantuar nga parashtruesi i kërkesës nuk është e nënshkruar dhe vulosur nga ana e palëve dhe e cila nuk dallonte për asnjë shkronje nga proforma e faturës. Ndërsa që të tri instancat gjyqësore në esencë iu ishin referuar çështjes së mos-harmonizimit të vlerës së deklaruar të mallit lëndor të paguar me transaksionin të 09 marsit 2017 dhe 06 qershorit 2017 në TEB Bank dhe faktit që të njëjtat në shumë prej 7,600 USD dhe 5,400 USD nuk harmonizohen me vlerën e faturës përcjellëse të mallit doganor nr. SHX/MONI01 të 20 prillit 2017 në vlerën totale prej 22.000 USD dhe kontratës me njëjtën vlerë. Parashtruesi i kërkesës, në ankesën e tij pranë Gjykatës së Apelit, dhe kërkesën e tij për ri-shqyrtim të jashtëzakonshëm pranë Gjykatës Supreme pretendoi vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sepse sipas tij gjykata e shkallës së parë ka gabuar me rastin e

leximit të përmbajtjes së transferit bankar të 6 qershorit 2017 pasi ka konsideruar se shuma e paguar është **5,400 USD,** mirëpo nga shkresat e lëndës shihet që është **15, 400 USD,** dhe potencon se vlera shënuar në faturën SHX/MONI01 të 24 shkurtit 2017 është 22,000.00 USD dhe pagesa prej 1,000.00 USD në emër të etiketave të produkteve lëndore dhe e cila nuk hyn në bazë doganore, dhe që të dyja urdhërpagesat në shumë prej 23,000.00 USD janë paguar në emër të faturës lëndore që është në harmoni me vlerat e pagesave me këtë faturë;

43. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pranë Gjykatës pretendim kryesor e ka çështjen e vërtetimit të gjendjes faktike, duke theksuar se Gjykata Supreme nuk ka trajtuar, përkatësisht nuk ka arsyetuar pretendimin e tij lidhur me shumën reale të paguar me transaksionin e 6 qershorit 2017, sepse të gjitha instancat kanë lexuar gabimisht shumën 15, 400 USD e cila në vendime gjyqësore është shënuar si 5,400 USD. Lidhur me këtë parashtruesi i kërkesës konsideron se përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me mungesën e dokumentacionit financiar për të vërtetuar çmimin e mallit, Gjykata Supreme ka miratuar qëndrimin e instancave më të ulëta përkundër faktit se transferet bankare vërtetojnë përputhjen me faturën dhe vërtetojnë çmimin e mallit.

44. Së dyti, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme do duhej të ishte kujdesur sipas detyrës zyrtare, që të gjejë shkelje sepse Gjykata e Apelit nuk ka mbajtur seancë sipas nenit 81G të Ligjit nr. 04/l-102 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/l-222. Rrjedhimisht, Gjykata do trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm fillimisht duke trajtuar parimet e përgjithshme të zhvilluara nga praktika e GJEDNJ-së dhe praktika e kësaj Gjykate lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore duke trajtuar pretendimin rreth gjendjes faktike, dhe çështjes së mbajtjes së seancës gjyqësore.

45. Rrjedhimisht, bazuar në specifikat e rastit konkret, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Sa i përket pretendimit për vendim të pa-arsyetuar gjyqësor

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore

46. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë,* Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës,* Aktgjykim i 19 prillit 1994; Hiro Balani kundër Spanjës, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; Higgins dhe të tjerët kundër Francës, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; Garcia Ruiz kundër Spanjës, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; Hirvisaari kundër Finlandës, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; Suominen kundër Finlandës, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; Buzescu kundër Rumanisë, Aktgjykim i 24 majit 2005; Pronina kundër Ukrainës, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe Tatishvili kundër Rusisë, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic,* Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring,* Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues Bedri Salihu, Aktgjykim, i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues Bayerische Versicherungsverbrand, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues Albert Rakipi, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

47. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së*, H. kundër Belgjikës,* Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring,* paragrafi 44).

48. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër*

Spanjës, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës,* Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës,* paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic,* të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring,* të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

49. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri,* Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. KI135/14, *IKK Classic,* Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI96/16 IKK Classic, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017 shih rastet e Gjykatës KI87/18 parashtrues *"IF Skadeforsikring",* Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; KI138/19 parashtrues *Ibish Raci,* cituar më lart, paragrafi 45; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138).

(ii) Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

50. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ankohet për arsyetimin e dhënë nga gjykatat e rregullta lidhur me vlerën e transaksionit përkatësisht, faktit që gjykata e shkallës së parë ka gabuar me rastin e leximit të përmbajtjes së transferit bankar të 6 qershorit 2017 pasi ka konsideruar se shuma e paguar është **5,400 USD,** mirëpo nga shkresat e lëndës shihet që është **15, 400 USD,** dhe potencon se vlera shënuar në faturën SHX/MONI01 të 24 shkurtit 2017 është 22,000.00 USD dhe pagesa prej 1,000.00 USD në emër të etiketave të produkteve lëndore dhe e cila nuk hyn në bazë doganore, dhe që të dyja urdhërpagesat në shumë prej 23,000.00 USD janë paguar në emër të faturës lëndore që është në harmoni me vlerat e pagesave me këtë faturë. Sipas parashtruesit të kërkesës, ky gabim është përcjellë edhe në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Së dyti,

parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka gjetur shkelje lidhur me faktin që Gjykata e Apelit nuk ka mbajtur seancë shqyrtuese siç kërkohet me nenin 81G të Ligjit nr. 04/l-102 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/l-222, duke mos arsyetuar në këtë pikë.

51. Në këtë drejtim Gjykata fillimisht rikujton arsyetimet e gjykatave të rregullta lidhur me refuzimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës. Në këtë aspekt Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit AA.nr. 682/2019, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës duke arsyetuar si në vijim:

> *"[...]sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ky kolegj konsideron se gjykata e shkalles së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, ngase nga provat e administruara, gjykata nuk ka mundur që të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se gjykata nuk i konteston faktet se ne transaksionet bankare të paraqitura ne shkresat e lëndës si përfitues i mjeteve është eksportuesi - subjekti ["Kompania L"], mirëpo vlerës se këtyre transaksioneve të mallit të deklaruar në Deklaratën Unike Doganore R-13844 të datës 16.06.2017 në ZBD Merdare. Gjykata nuk ka mundur të bëj harmonizimin e vlerës së deklaruar të mallit lëndor me vlerën e paguar të transaksionit të prezantuar sipas transfereve bankare të datës 09.03.2017 dhe 06.06.2017 TEB Bank, paditësi po ashtu as ne seancën gjyqësore nuk ka sqaruar se pse vlera e këtyre transaksioneve bankare në shume prej 7600 USD dhe 5400 USD, nuk harmonizohen me vlerën e faturës përcjellëse te mallit doganor nr. SHX/MONI01 të datës 20.04.2017 që ka vlerën totale prej 22000 USD, dhe kontratës te datës 24.02.2017 që ka te njëjtën vlerë. Andaj, gjykata nga provat e administruara nuk ka mundur të vërtetoj se paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën reale te mallit lëndor sipas faturës përcjellëse të mallit. Prandaj, gjykata e shkalles së parë drejte ka vendosur kur ka vlerësuar se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor nga zyra e pranimit qendror, duke aplikuar metodën e 6 te vlerësimit nga neni 35 te Kodit Doganor dhe Akcizave, përkatësisht te dhënave te disponueshme qe disponon Dogana e Kosovës (DUD-i R-13880/2016). Andaj me të drejtë konstatohet se paditësi ne ketë konflikt administrativ nuk ka provuar se vlera e mallit lëndor është e përafërt me vlerën e mallrave identike apo të ngjashme të shitura për eksport ne Kosovë, te paraqitura ne të*

njëjtën kohe, qe në ketë rast do te aplikohej dispozita e nenit 34 par.2 pika. a) dhe b) e Kodit Doganor dhe Akcizave te Kosovës.

Kolegji i kësaj gjykate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes gjen se gjykata e shkalles se parë nuk ka gjetur fakte te bazuara qe argumentojnë se paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën reale te mallit lëndor. Prandaj, gjykata e shkalles së parë me të drejtë vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor duke aplikuar metodën e 6 të vlerësimit nga neni 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, pasi qe këto të dhëna janë marrë nga doganimet e rregullta neper dege dhe si vlerë referencë është marre çmimi i mallit nga dosja e vlerave, përkatësisht çmimet e marra nga reuters si çmim të berzës në kohën e blerjes se mallrave, DUD-i R-13880/2016. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LPA, LKA, Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, si dhe Kodit nr.03/L-109 Doganor dhe te Akcizave në Kosovë."

52. Sa i përket vlerës së mallit Gjykata e Apelit arsyetoi:

"Çmimi i transaksionit dhe çmimi realisht i paguar për mallin qe e ka importuar dhe deklaruar me ane te deklaratës doganore kontestuese është, 22.000.00 USD. Kushtet e dërgesës për ketë mall janë caktuar në baze te paritetit CFR Durrës. Vlera e këtij malli është shënuar ne faturën SHX/MONI01 te datës 24.02.2017, përkatësisht shuma prej 22.000.00 USD, pastaj po në këtë fature nga eksportuesi është shtuar edhe pagesa prej 1.000.00 USD ne emër te vendosjes së etiketave në produkt lëndor. Këto pretendime ankimore ky kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë te pa bazuara, te pa argumentuara ne prova konkrete dhe nuk kane mbështetje ligjore për tu aprovuar ankesa, për faktin se gjykata e shkalles se pare nga administrimi i të gjitha provave ne ketë procedure të konfliktit administrativ ka ardhur ne përfundim se paditësi nuk ka qene në gjendje qe gjykatës t'ia dëshmoje provat qe dëshmojnë vlerën e transaksionit te paguar për mallin lëndor kështu qe edhe sipas vlerësimit te kolegjit të kësaj gjykate nuk mund të pranohet pretendimet se dokumentacioni përcjellës i mallit është ne përputhje me nenin 123 te Udhëzimit Administrativ 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, ne rastin konkret është vërtetuar bindshëm dhe ne mënyre të pa kontestuar se nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme që dëshmojnë

se paditësi ka paguar vlerën e vërtete të transaksionit të mallit lëndor. Andaj, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkalles se parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye te mjaftueshme për faktet vendimtare te cilat i pranon edhe kjo gjykate, ashtu qe ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejte dhe i ligjshëm."

53. Gjykata poashtu rikujton se Gjykata Supreme përmes Aktvendimit të saj ARJ-UZVP-nr.72/2020, kishte arsyetuar si në vijim, duke iu referuar provave të administruara, përkatësisht gjendjes faktike:

"[...] gjykatat e instancave më të ulëta [...] kanë konstatuar drejtë se në shkresat e lëndës nuk ka mundur të gjendet asnjë provë e cila do vërtetonte se paditësi ka paguar vlerën reale të transaksionit të mallit të importuar siç parashihet me nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës Nr.03/L-109 dhe se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor nuk është në pajtim me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009. Për t'u pranuar vlera e paguar e transaksionit sipas metodës për përcaktimin e vlerës së mallit të importuar sipas nenit 34 paragrafi 2 pika (a) dhe (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, paditësi në rastin konkret duhet të dëshmoj se vlera e mallit lëndor është e përafërt me vlerën e mallit identik apo të ngjashëm të shitur për eksport në Kosovë. Sipas mendimit të kësaj gjykate, sipas transaksioneve bankare të paraqitura në shkresat e lëndës nuk kontestohet se "Kompania L" është shfrytëzues, mirëpo gjykata nuk ka mundur të bëjë harmonizimin e vlerës së këtyre transaksioneve me vlerën e deklaruar të mallit lëndor sipas faturës përcjellëse të prezantuar për mallin e deklaruar në [DUD] R13844/16.06.2017 në ZBD Merdare. Gjykata nuk ka mundur të bëjë harmonizimin e vlerës së deklaruar të mallit lëndor me vlerën e paguar të transaksionit të prezantuar sipas të transfereve bankare të datës 09.03 2017 shumën prej 7,600 USD, ndërsa me 06.06.2017 shumën prej 5,400 USD dhe pse vlera e këtyre transaksioneve nuk harmonizohet me faturën përcjellëse SHX/MONI01 të 20 .04.2017 me faturën e vlerës totale 22,000 USD, dhe kontratën e datës 24.02.2017 që ka të njëjtën vlerë. "

54. Më tej, Gjykata Supreme theksoi se:

[...] kjo gjykatë është e mendimit se paditësi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë dhe të harmonizuar me vlerën reale të mallit të paguar. Përkatësisht, faktet vendimtare, ato me relevantet, siç janë transferet bankare dhe deklarata e eksportit, të harmonizuara me vlerat e faturave, në kuptim te nenit 123 të

Udhëzimit Administrativ 11/2009, gjykata nuk ka mundur t'i vërtetoj, prandaj nuk ka mundur te pranoj pretendimin nga padia se vlera e deklaruar e mallit paraqet vlerën e saj reale. Andaj, kjo gjykate i pranon konstatimet e organit te paditur se paditësi nuk ka prezantuar dokumentacionin e kompletuar me te cilin do te vërtetohej se çmimi i deklaruar është njëherit edhe vlera reale e mallit (neni 34 paragrafi 2 pika (a) dhe (b) i Kodit Doganor dhe i Akcizave te Kosovës). Meqë gjykatat e instancave te ulëta, në bazë të provave ne shkresa të lendes, nuk kanë mundur te vërtetojnë pretendimet e paditësit se paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën reale në baze të faturave, del që gjykatat e instancave të ulëta në mënyre të drejtë kane vërtetuar se e paditura ka vepruar në mënyre ligjore atëherë kur ka vendosur lidhur me vlerësimin e ri të mallit lëndor dhe aplikimin e metodës numër 6, te parashikuar me nenin 35 të Kodit për doganat dhe akcizat nr. 03/L-109, gjegjësisht të vlerësimit në baze të të dhënave me te cilat disponon dogana."

55. Gjykata rikujton se, në rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë, si në rastin e parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme, e cila vërteton vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit e as atë të Gjykatës Themelore përmes të cilave është refuzuar padia dhe ankesa e parashtruesit të kërkesës por vetëm ka vërtetuar ligjshmërinë e tyre, duke qenë se, sipas Gjykatës Supreme, nuk kishte shkelje esenciale të procedurës dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale në këtë procedurë (shih, *mutatis mutandis,* rastet e Gjykatës KI194/18, parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shkurtit 2020, paragrafi 106; dhe KI122/19, parashtrues *F.M.,* Aktvendim për papranueshmëri, i 9 korrikut 2020, paragrafi 100).

56. Bazuar nga arsyetimet e lartcekura të Gjykatës së Apelit, dhe Gjykatës Supreme Gjykata vëren se që të dyja, në esencë kanë arsyetuar se (i) për t'u pranuar vlera e paguar e transaksionit sipas metodës për përcaktimin e vlerës së mallit të importuar sipas nenit 34 paragrafi 2 pika (a) dhe (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave, parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmoj se vlera e mallit lëndor është e përafërt me vlerën e mallit identik apo të ngjashëm të shitur për eksport në Kosovë; (ii) duke qenë se nuk ka mundur të vërtetohet se parashtruesi i kërkesës i ka paguar eksportuesit vlerën reale në baze të faturave, atëherë me rregull është vendosur lidhur me vlerësimin e ri të mallit lëndor dhe aplikimin e metodës numër 6, te parashikuar me nenin 35

të Kodit Doganor dhe Akcizave; (iii) dokumentacioni përcjellës i mallit nuk është në përputhje me nenin 123 te Udhëzimit Administrativ 11/2009; (iv) nuk është mundur të bëhet harmonizimi i vlerës së deklaruar të mallit lëndor me vlerën e paguar të transaksionit të prezantuar sipas transfereve bankare në TEB Bank të 09 marsit 2017 në shumë prej 7,600 USD dhe 06 qershor 2017 në vlerën prej 5,400 USD, dhe se këto nuk harmonizohen me vlerën e faturës përcjellëse te mallit doganor nr. SHX/MONI01 të 20 prillit 2017 që ka vlerën totale prej 22,000 USD, dhe kontratës të 24 shkurtit 2017 që ka të njëjtën vlerë.

57. Gjykata e Apelit për më tepër kishte theksuar se vlera e mallit është shënuar në faturën SHX/MONI01 të datës 24 mars 2017, në shumën prej 22,000.00 USD, pastaj po në këtë faturë nga eksportuesi është shtuar edhe pagesa prej 1.000.00 USD në emër të vendosjes së etiketave në produkt lëndor. Por për këtë Gjykata e Apelit kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoje provat qe dëshmojnë vlerën e transaksionit te paguar për mallin lëndor.

58. Nga dispozitat ligjore të aplikuara në këtë rast nga gjykatat e rregullta, Gjykata vëren që Kodi Doganor dhe i Akcizave, përcakton në nenin 34 paragrafi 2 se vlera e përcaktuar doganore sipas këtij neni do të jetë nën pikën (a) vlera e transaksionit të mallrave identike të shitura për eksport për Kosovë dhe të eksportuara në te njëjtën kohë, ose përafërsisht, në të njëjtën kohë me mallrat që janë duke u vlerësuar dhe (b) vlera e transaksionit të mallrave të ngjashme të shitura për eksport për Kosovë dhe të eksportuara në të njëjtën kohë ose përafërsisht në të njëjtën kohë me mallrat qe janë duke u vlerësuar. Më pas, ky Kod në nenin 35 paragrafi 1 përcakton se kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 ose 34, do të përcaktohet në bazën e të dhënave të disponueshme në Kosovë, duke përdorë metoda të arsyeshme në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesit të kërkesës nuk iu ishte miratuar pretendimi se ai ka paguar vlerën reale të transaksionit të mallit të importuar siç parashihet me nenin 33 të Kodit Doganor dhe Akcizave, dhe nuk ishte pranuar vlera e paguar e transaksionit sipas metodës për përcaktimin e vlerës së mallit të importuar me nenin 34 paragrafi (a) dhe (b) i Kodit Doganor dhe të Akcizave. Në fund, lidhur me dokumentet e parashtruara, Gjykata rikujton se neni 123 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ 11/2009 i liston dokumentet që duhet bashkangjitur deklaratës doganore, dhe të cilat janë: (a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti; (b) Kur kërkohet sipas Nenit 88 të këtij

akti, deklarata për vlerat doganore të mallrave të deklaruara i bëjnë në përputhje me kushtet e paraqitura në nenin e dhënë; (c) Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruara; (d) Të gjitha dokumentet e tjera të kërkuara për aplikimin e dispozitave që rregullojnë lirimin për qarkullim të lirë të mallrave të deklaruara. Në rastin e parashtruesit, gjykatat e rregullta kishin konsideruar se nuk plotësohen kushtet.

59. Në rastin konkret, nuk është kontestuese që parashtruesi i kërkesës ka kryer transaksione bankare (pagesa) në llogarinë e "Kompanisë L"., dhe nuk është kontestues fokusi i të gjitha gjykatave të rregullta ishte në vlerën e mallit të importuar. Kontestuese janë përgjigjet e gjykatave të rregullta lidhur me harmonizimin e vlerës së këtyre transaksioneve me vlerën e deklaruar të mallit lëndor sipas faturës përcjellëse.

60. Në rastin konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij dhe në kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm ka pretenduar se vlera e shënuar si transaksion në tranferin bankar të 6 qershorit 2017 nuk është 5,400 USD por 15,400 USD. Gjykata e Apelit, dhe ajo Supreme nuk kanë sqaruar se pse nuk kanë mundur të bëjnë harmonizimin e vlerës së deklaruar të mallit lëndor me vlerën e paguar të transaksionit të prezantuar sipas transfereve bankare në TEB Bank të 09 marsit 2017 në shumë prej 7,600 USD dhe 06 qershor 2017 në vlerën prej 5,400 USD, dhe se këto nuk harmonizohen me vlerën e faturës përcjellëse të mallit doganor nr. SHX/MONI01 të 20 prillit 2017 që ka vlerën totale prej 22,000 USD, dhe kontratës te datës 24 shkurtit 2017 që ka të njëjtën vlerë.

61. Sidoqoftë, Gjykata duke rikujtuar se janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih paragrafin 48 më lart, dhe referencat e përdorura aty). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih paragrafët 48 më lart, dhe referencat e përdorura aty).

62. Përderisa Gjykata ka parasysh që sipas arsyetimet e gjykatave të rregullta lidhur me aplikueshmërinë e nenit 33, 34 e 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, Gjykata poashtu merr parasysh dhe argumentin e parashtruesit lidhur me harmonizimin e vlerës së paguar të transaksioneve përmes transfereve bankare, dhe vlerës së faturës

përcjellëse të mallit doganor nr. SHX/MONI01 të 20 prillit 2017 që ka vlerën totale prej 22,000 USD. Lidhur me këtë pikë, Gjykata vëren se nga shkresat e lëndës, transferi i realizuar në TEB Bank i 06 qershorit 2017 i shënuar në të gjitha instancat gjyqësore si vlerë prej 5,400 USD, në fakt është në vlerë prej 15,400 USD. Kjo do rezultonte në një transaksion prej 23,000 USD, e sipas pretendimit të parashtruesit 22,000 USD për faturën përcjellëse të mallit doganor, ndërsa 1,000 USD të paguar në emër të tiketave, e cila sipas parashtruesit nuk hyn në bazë doganore për llogaritjen e detyrimeve të importit.

63. Gjykata nuk mund të vlerësojë nëse rregullimi i këtij gabimi teknik përkatësisht zëvendësimi i shumës prej 5,400 USD, e që realisht është 15,400 USD në transferin bankar të 6 qershorit 2017 ngërthen në vetvete ndonjë ndryshim lidhur me harmonizimin e vlerës së deklaruar të mallit lëndor me vlerën e paguar të transaksionit të prezantuar sipas transfereve bankare. Parashtruesi i kërkesës e konsideron këtë pretendim thelbësor sepse *"transferet bankare vërtetojnë përputhjen me faturën dhe vërtetojnë çmimin e mallit. "* Andaj, Gjykata konsideron se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është thelbësor dhe mund të jetë përcaktues lidhur me meritat e padisë së parashtruesit të kërkesës. Lidhur me këtë pretendim specifik, të parashtruesit të kërkesës Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme kanë heshtur.

64. Heshtja e gjykatave përkitazi me pretendime me rëndësi të parashtruesve përkatës është shqyrtuar specifikisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Për shembull, në rastet, *Ruiz Torija kundër Spanjës,* cituar më lart dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, GJEDNJ, përtej parimeve të përgjithshme përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, gjithashtu kishte adresuar rrethanat në të cilat gjykatat përkatëse kishin heshtur lidhur me argumentet, të cilat GJEDNJ i cilësoi si thelbësore. Në të dy rastet, GJEDNJ shqyrtoi nëse heshtja e gjykatës përkatëse mund të interpretohet në mënyrë të arsyeshme si një refuzim i nënkuptuar i argumenteve të palëve. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28). Megjithatë, në mungesë të arsyetimit përkatës, GJEDNJ theksoi se është e pamundur të konstatohet nëse gjykatat përkatëse thjesht kanë neglizhuar të merren me pretendimet përkatëse apo kanë nënkuptuar refuzimin e tyre dhe, nëse ky ishte qëllimi i saj, cilat ishin arsyet e saj për një qasje të tillë. (Shih, rastet e GJEDNJ-së: *Hiro Balani kundër Spanjës,* cituar më lart, paragrafi 28; dhe *Ruiz Torija kundër Spanjës,* cituar më lart, paragrafi 29 dhe 30). Në të dy rastet, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin e Gjykatës KI24/20, parashtrues *"PAMEX SH.P.K",* Aktgjykim i 3 shkurtit 2021, paragrafi 57).

65. Rrjedhimisht, Gjykata në rrethanat e rastit konkret, duke marrë parasysh që Gjykata Supreme, ka dështuar të adresojë dhe arsyetojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës të ngritura para saj, Gjykata një vendim gjyqësor të tillë, nuk mund të jetë kompatibil me standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, siç janë të përcaktuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe praktikës përkatëse gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së.

66. Për fund, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës poashtu ka ngritur pretendimin se Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar dhe gjetur shkelje lidhur me mbajtjen e seancës shqyrtuese në Gjykatën e Apelit. Megjithatë një pretendim të tillë parashtruesi nuk e ka ngritur në kërkesën e tij për ri-shqyrtim të jashtëzakonshëm, dhe Gjykata të njëjtën nuk do e marrë parasysh për këtë arsye.

67. Prandaj, dhe përfundimisht duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konsideron që Aktvendimi i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktvendimi i Gjykatës Supreme ARJ-UZVP-nr.72/2020 i 28 tetorit 2020 është nxjerrë në shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse ka dështuar të adresojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës përkitazi me pretendimin për gabimin në leximin e transaksionit bankar të 6 qershorit 2017 dhe çështjes së harmonizimit të tij me vlerën e faturës përcjellëse të mallit doganor nr. SHX/MONI01 të 20 prillit 2017.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 59 (1) të Rregullores së punës, më 24 shtator 2021, me shumicë

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP-nr.72/2020 të 28 tetorit 2020;

IV. TË KTHEJË Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP-72/2020 të 28 tetorit 2020, për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më datën 28 mars 2022 për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;

VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Radomir Laban	Gresa Caka-Nimani

KI01/21, Parashtruese: Ajshe Aliu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 37/2020 të 11 qershorit 2020

KI01/21, Aktgjykim i 7 tetorit 2021, publikuar më 1 nëntor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, mungesë e arsyetimit të vendimit gjyqësor*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me të drejtën e pretenduar të një nëne biologjike për njoftuar/kontaktuar fëmijën e saj të dhënë në adoptim dhe i cili tashmë ka arritur moshën madhore, në specifikat e sqaruar në Aktgjykimin e publikuar. Çështjet që ngërthen kërkesa, ndër të tjera, ndërlidhen me të drejtën në jetë private, dhe parimet e përjashtimet përkatëse, siç janë garantuar përmes neneve respektive të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe praktikës përkatëse të Gjykatës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Më specifikisht, nga shkresat e lëndës rezultoi se parashtruesja e kërkesës, më 1 mars 2016, në Qendrën për Punë Sociale në kuadër të Komunës së Prishtinës kishte parashtruar kërkesë, përmes së cilës kishte kërkuar që fëmija i saj biologjik i moshës madhore, të cilin e kishte dhënë për birësim në vitin 1989, të njoftohet për: (i) ekzistimin e nënës së tij biologjike; dhe (ii) interesimin e saj për ta njoftuar atë. Qendra për Punë Sociale ishte përgjigjur duke theksuar se (i) nuk ka bazë ligjore për të njoftuar fëmijën e saj biologjik në lidhje me birësimin e tij; dhe se (ii) bazuar në paragrafin 2 të nenit 194 (Parimet) të Ligjit për Familjen të Kosovës, qasja në informatë në lidhje me prindërit biologjikë i garantohet vetëm fëmijës së adoptuar të moshës madhore në bazë të kërkesës së tij/saj. Si rezultat i kërkesës së parashtrueses së kërkesës për rishqyrtim të përgjigjes së Qendrës për Punës Sociale, konstatimi i kësaj të fundit ishte konfirmuar edhe nga Komisioni i Ankesave në kuadër të Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Për pasojë, parashtruesja e kërkesës në Gjykatën Themelore në Prishtinë kishte parashtruar kërkesëpadi përmes së cilës, ndër tjerash, kishte kërkuar që të detyrohet Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare që të informojë fëmijën e saj biologjik në lidhje me birësimin e tij. Gjykata Themelore e kishte refuzuar si të pabazuar padinë e parashtrueses së kërkesës duke vërtetuar konstatimet e lartcekura të Qendrës për Punë Sociale dhe të Komisionit për Ankesa pranë Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe duke konstatuar se bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Qendra për Punë Sociale nuk është e obliguar që të njoftojë fëmijën në lidhje me birësimin e tij dhe se të drejtën e qasjes në të dhëna të tilla e ka vetëm i adoptuari i moshës madhore në bazë të kërkesës së tij. Në vijim, parashtruesja e kërkesës kundër këtij Aktgjykimi të Gjykatës

Themelore, kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, dhe kjo e fundit kishte refuzuar ankesën e saj e si të pabazuar duke vërtetuar konstatimin e gjykatës së shkallës së parë. Si rezultat i kërkesës së parashtrueses së kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të parashtruar në Gjykatën Supreme, kjo e fundit përmes Aktgjykimit të 11 qershorit 2020, këtë kërkesë të parashtrueses së kërkesës gjithashtu e kishte refuzuar si të pabazuar. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar kishe vërtetuar konstatimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit dhe kishte përfunduar se të dhënat dhe rrethanat e adoptimit nuk duhet të zbulohen ose të hulumtohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe të fëmijës, përveç nëse kjo kërkohet për arsye të veçanta dhe për arsye të interesit publik.

Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës i kontestoi konstatimet e lartcekura të Gjykatës Supreme, përfshirë edhe ato të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë. Thelbi i pretendimit të parashtrueses së kërkesës para Gjykatës ishte se gjykatat e rregullta i kanë shkelur asaj të drejtën për jetë private, të garantuar me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke mos i miratuar asaj kërkesën për njoftimin e fëmijës së saj biologjik në lidhje me ekzistimin e nënës së tij biologjike dhe interesimin e parashtrueses së kërkesës për ta njoftuar atë. Si rezultat i kësaj, ajo po ashtu kishte pretenduar: (i) shkelje të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor; dhe (iii) shkelje të nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata u fokusua në garancitë e mishëruara në nenin 36 (E Drejta e Privatësisë) të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe në këtë kontekst, së pari shtjellojë parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe më pas, aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata theksoi se kërkesa e parashtrueses së kërkesës, përmes së cilës kishte shprehur interesimin e saj për ta njoftuar fëmijën e saj të dhënë për adoptim në vitin 1989, ngërthen elemente që i përkasin një pjese të rëndësishme të identitetit të saj si nënë biologjike dhe të cilat afektojnë të drejtën e saj për jetë private në kuptim të nocionit të "*jetës së saj private*" të garantuar me paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Thënë këtë, duke pasur parasysh që ky pretendim afekton të drejtën e saj për jetë private, Gjykata rikujtoi se, sipas praktikës së saj dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit të rasteve për të konstatuar nëse në një rast konkret ka pasur kufizim dhe shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Konventë, aplikon të njëjtat koncepte, përkatësisht nëse kufizimi apo

ndërhyrja përkatëse: (i) është "*në përputhje me ligjin*" ose "*e përcaktuar me ligj*"; (ii) ka "*ndjekur një qëllim legjitim*"; dhe (iii) është "*e domosdoshme në një shoqëri demokratike*." Në këtë kontekst, Gjykata në rrethanat e rastit konkret, vlerësoi se vendimet e gjykatave të rregullta, përmes së cilave ishte refuzuar kërkesa specifike e parashtrueses së kërkesës: (i) ishin të bazuara në ligj; (ii) kishin ndjekur një qëllim legjitim – mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të fëmijës së adoptuar dhe familjes së tij adoptuese; dhe (iii) kishin ndjekur një ekuilibër të drejtë në mes të interesave të fëmijës së adoptuar, tashmë të moshës madhore, dhe respektimin e të drejtës së tij private dhe familjare brenda familjes së tij adoptuese.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerësoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk ishte i përfshirë në shkelje të së drejtës së saj për jetë private të garantuar me paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ndërsa, përkitazi me pretendimin për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata, duke aplikuar parimet e përgjithshme të vendosura përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke rikujtuar që bazuar në të njëjtat dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret, konstatoi se në rrethanat parashtrueses së kërkesës, Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmbush kriteret dhe standardin për një vendim të arsyetuar gjyqësor, ashtu siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës.

Përfundimisht, mbështetur në rrethanat e rastit konkret dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është në pajtueshmëri me (i) nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe po ashtu (ii) nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejtat në proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI01/21

Parashtruese

Ajshe Aliu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 37/2020, të 11 qershorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesja e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ajshe Aliu, të cilën e përfaqësojnë Artan Qerkini dhe Florin Vërtopi, avokatë në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [ARJ-UZVP. nr. 37/2020] e 11 qershorit 2020, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [AA. nr. 178/2019] të 15 majit 2020, të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [A. nr. 651/16] të 25 janarit 2019, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

3. Parashtruesja e kërkesës, Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 18 nëntor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ); nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së; si dhe nenin 7 [pa titull] të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 5 janar 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës.

7. Më 18 janar 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.

8. Më 2 shkurt 2021, Gjykata i njoftoi përfaqësuesit ligjorë të parashtrueses së kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe gjithashtu nga të njëjtit kërkoi që të dorëzojnë autorizimin e vlefshëm për përfaqësim në Gjykatën Kushtetuese.

9. Më 16 shkurt 2021, Gjykata pranoi autorizimin e kërkuar për përfaqësim.

10. Më 18 shkurt 2021, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme kopjen e kërkesës, dhe të njëjtën ditë Gjykatës Themelore i kërkoi që të dorëzojë

fletëkthesën, e cila dëshmon se kur parashtruesja e kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

11. Më 19 shkurt 2021, Gjykata Themelore e dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës.

12. Më 4 mars 2021, Gjykata ia ktheu Gjykatës Themelore dosjen e lëndës.

13. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

14. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

15. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KK160/21, përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohet kryesuese në Kolegje shqyrtuese në rastet ku është caktuar si anëtare e Kolegjit, duke përfshirë rastin aktual.

16. Më 1 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama–Hajrizi, përmes Vendimit Nr. KI01/21, caktoi gjyqtarin Radomir Laban si gjyqtar raportues në vend të gjyqtares Gresa Caka-Nimani.

17. Më 8 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama–Hajrizi nxori Vendimin Nr. K.SH.KI 01/21 për caktimin e gjyqtares Gresa Caka-Nimani si anëtare në Kolegjin shqyrtues në vend të gjyqtarit Radomir Laban.

18. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

19. Më 7 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi që kërkesa e parashtrueses së kërkesës është e pranueshme dhe se Aktgjykimi [ARJ-UZVP. nr. 37/2020] i 11 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme: (i) është në pajtueshmëri me nenin 36 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së; dhe (ii) është në pajtueshmëri me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

20. Më 1 mars 2016, parashtruesja e kërkesës, në Qendrën për Punë Sociale në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: Qendra për Punë Sociale) parashtroi kërkesën (e titulluar "Kërkesë për njoftimin e fëmijës madhor për nënën e tij biologjike") përmes së cilës kërkoi që fëmija i saj biologjik, i moshës madhore, të cilin e kishte dhënë për adoptim në vitin 1989 të njoftohet: (i) në lidhje me ekzistimin e nënës së tij biologjike; dhe (ii) interesimin e saj për ta njoftuar atë.

21. Parashtruesja e kërkesës, përmes kërkesës së saj shprehimisht kishte kërkuar si në vijim *"[...], kërkojmë nga ju që si organ kompetent tek i cili duhet drejtuar kjo çështje, t'i ndermerrni hapat e nevojshëm që ta njoftoni fëmijën madhor, dikur me emrin [X.X], me ekzistimin e nënës së tij biologjike, dhe ta njoftoni ne lidhje me interesimin e kësaj të fundit për tu njoftuar me të".*
"1. Prandaj, marrë parasysh të gjitha argumentet dhe faktet e ofruara më lart, kërkojmë nga ju që pas shqyrtimit të të njëjtave, ta njoftoni për birësimin e kryer madhorin në fjale me shënime të përshkruara më lartë, në këtë parashtresë, në lidhje me të drejtat ligjore që i takojnë, qoftë sipas legjislacionit tonë apo atij ndërkombëtar, në mënyrë që Ai të jetë në gjendje të vendosë nëse dëshiron ta shfrytëzojë të drejtën për ta kontaktuar nënën e tij biologjike.
[...]."

22. Kërkesën e saj, parashtruesja e kërkesës e bazoi në nenin 194 [Parimet] paragrafin 2 të Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Familjen), nenin 8 të KEDNJ-së dhe nenin 22 [Qasja dhe zbulimi i informatave] të Konventës Evropiane për Adoptimin e Fëmijëve, të Këshillit të Evropës, e ndryshuar dhe miratuar më 27 nëntor 2008 (në tekstin e mëtejmë: Konventa për Adoptim).

23. Më 7 mars 2016, Qendra për Punë Sociale përmes shkresës [nr. Protokolli: 05/55-128] ndaj kërkesës, të 1 marsit 2016, të parashtrueses së kërkesës, u përgjigj si në vijim: *"Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së [Qendrës për Punë Sociale] nuk ka asnjë mbështetje ligjore dhe asnjë obligim ligjor që të informojë fëmijën e adoptuar për familjen biologjike, në asnjë rrethanë, pasi që kjo e drejt është e rezervuar ekskluzivisht për fëmijën e braktisur, pa marrë parasysh se a njihen apo jo prindërit biologjik, përderisa fëmiu biologjik nuk paraqet kërkesë me shkrim për njohjen e prindit/erve biologjik. Ndërsa në rastin konkret kërkesa e paraqitur nga nëna biologjike e cila konform dispozitave të lartpërmendura [neni 194 i Ligjit për Familjen i Kosovës dhe neni 17 [Pas themelimit të adoptimit], paragrafi 3 dhe neni 18 [dispozitat e tjera] paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 09/2014 për rregullimin e procedurave të adoptimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore] i pamundëson organit të kujdestarisë –QPS dhënien e informatave lidhur me fëmijën. E drejta ekskluzive për kërkim të prindit/ërve biologjik është e fëmijës".*

24. Më 11 mars 2016, parashtruesja e kërkesës në Qendrën për Punë Sociale parashtroi kërkesë për rishqyrtim të përgjigjes, së 7 marsit 2016, të Qendrës për Punë Sociale. Parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj për rishqyrtim të Përgjigjes së lartcekur specifikoi se *"kërkesa e saj nuk ka qenë mbi informimin e [saj] për të dhënat dhe rrethanat për adoptim, por ka qenë mbi kërkesën dhe obligimin që [Qendra për Punë Sociale] ka që ta njoftojë fëmijën madhor në lidhje me birësimin e tij".*

25. Më 17 mars 2016, Qendra për Punë Sociale, përmes shkresës së saj [05/55-141] kërkesën e parashtrueses së kërkesës e adresoi tek Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale [në tekstin e mëtejmë: Departamenti i MPMS-së].

26. Më 25 mars 2016, Komisioni për Shqyrtim dhe Vendosjen e Ankesave në shkallë të dytë në kuadër të Departamenti të MPMS-së (në tekstin e mëtejmë: Komisioni për Ankesa i MPMS-së), përmes Aktvendimit [DPSF nr. 521] kërkesën e parashtrueses së kërkesës për rishqyrtim të përgjigjes së Qendrës për Punë Sociale, të 11 marsit 2016 e refuzoi si të pabazuar. Komisioni për Ankesa, në Aktvendimin e tij, duke iu referuar paragrafit 1 të nenit 194 të Ligjit për Familjen dhe paragrafit 3 të nenit 17, dhe paragrafit 1 të nenit 18 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 09/2014 për rregullimin e procedurave të adoptimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore (në tekstin e mëtejmë: Udhëzimi Administrativ i MPMS-së) konkludoi se *"[Qendra për Punë*

Sociale]nuk ka asnjë mbështetje ligjore dhe obligim ligjor që ta informoj fëmijën e adoptuar për familjen biologjike përderisa fëmiu biologjik nuk paraqet kërkesë me shkrim për njohjen e prindërve biologjik. E drejta ekskluzive për kërkim të prindit/ërve biologjik është e fëmijës".

27. Më 29 prill 2016, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore për konflikt administrativ, përmes së cilës kërkoi që: (i) të aprovohet padia e saj; (ii) të anulohet Aktvendimi, i 25 marsit 2016, i Komisionit për Ankesa i MPMS-së; dhe (iii) të detyrohet Departamenti i MPMS-së që të informojë fëmijën në lidhje me të drejtat e tij që rrjedhin nga neni 194, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen dhe nenit 18, paragrafit 1 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së.

28. Më 7 maj 2018, Avokati Shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë, në cilësinë e përfaqësuesit të Departamentit të MPMS-së, si palë e paditur në procedurë paraqiti përgjigje ndaj padisë së parashtrueses së kërkesës, përmes së cilës kërkohej që të hedhet poshtë padia e parashtrueses së kërkesës si e pabazuar. Arsyetimin i përgjigjes në padi ishte mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi, sipas të cilave MPMS në cilësinë e të paditurës theksoi se: (i) të dhënat për adoptim nuk mund të zbulohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe fëmijës, përveç nëse e kërkojnë rrethanat e interesit publik; (ii) e drejta ekskluzive për informata i takon fëmijës së adoptuar; dhe (iii) Qendra për Punë Sociale është e obliguar që ta ruajë konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijës gjatë tërë procesit të adoptimit dhe pas adoptimit dhe në asnjë rrethane nuk duhet të ofrojë dokumentacionin ose informacion nga dosja e fëmijës, përjashtimisht personave zyrtarë kompetent në QPS, DPSF dhe gjykatë.

29. Më 25 janar 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.651/16] padinë e parashtrueses së kërkesës e refuzoi si të pabazuar.

30. Gjykata Themelore, në Aktgjykimin e saj, fillimisht iu referua nenit 194 të Ligjit për Familjen, paragrafit 3 të nenit 17 dhe paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 18 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së, nenit 8 të KEDNJ-së, nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe nenit 22 të Konventës Evropiane për Adoptimin e Fëmijës. Bazuar në dispozitat e lartcekura dhe provat e administruara, Gjykata Themelore konstatoi se: *"[...] të dhënat e të adoptuarit duhet të ruhen gjatë tërë dhe pas procesit të adoptimit, dhe QPS [Qendra për Punë Sociale], ka për detyrë ti zbulojë ato vetëm në rast e përpara si me ligj, dhe në rast se aplikues/kërkues është vetë i adoptuari madhor, që do të thotë se të*

drejtë të qasjes në to, e cila nuk mund ti mohohet nga askush, ka i adoptuari madhor".

31. Në vijim të kësaj të fundit, Gjykata Themelore konkludoi se Komisioni i Ankesave i MPMS-së në bazë të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e të drejtës procedurale dhe asaj materiale.

32. Më 6 shkurt 2019, kundër Aktgjykimi të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak: (i) të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale; dhe (ii) shkeljeve thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK). Në ankesën e saj, parashtruesja e kërkesës, në kuptim të pretendimit për shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së ndër tjerash specifikoi se: (i) ajo nuk ka kërkuar asnjëherë që asaj t'i mundësohet qasja në dokumentacionin e adoptimit të fëmijës së saj biologjik, duke qenë e vetëdijshme se në këtë drejtim do të kishte hasur ne pengesa ligjore të përcaktuar me nenin 194 të Ligjit të Familjes por se ka kërkuar që *"femiu i saj biologjik te njoftohet për rrethanat e adoptimit, ne mënyrë qe ai nëse dëshiron të ketë mundësi, ashtu siç e parashikon neni 194 i Ligjit te Familjes, të njoftohet me faktin se kush është nena e tij biologjike.";* (ii) Gjykata themelore nuk ka ofruar arsyetim se pse Qendra për Punë Sociale e ka të ndaluar të njoftojë fëmijën e saj biologjik "*se ai është adoptuar në familjen adoptuese";* (iii) rithekson faktin se *"gjinia e gjakut është pengesë martesore, ndërsa potencialisht fëmija biologjik i paditëses, tashme i adoptuar, mund të martohet me fëmijët biologjik të paditëses, që i kane lindur asaj në martesën ekzistuese"* ; (iv) Gjykata Themelore nuk ka arsyetuar pse në rastin e saj nuk gjen zbatim neni 7 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve; dhe (v) Aktgjykimi i kontestuar nuk i plotëson standardet e vendimit të arsyetuar gjyqësor, ashtu siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

33. Më 15 maj 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.178/2019] ankesën e parashtrueses së kërkesës e refuzoi si të pabazuar.

34. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata e Apelit konstatoi se: (i) nuk ka mbështetje ligjore dhe obligim ligjor që Qendra për Punë Sociale ta njoftojë fëmijën e adoptuar tashmë të moshës madhore për nënën e tij biologjike përderisa ai nuk ka paraqitur kërkesë për njohjen e prindërve biologjikë; dhe (ii) " *[...] të dhënat për adoptimin dhe rrethanat e tij nuk duhet të zbulohen ose hetohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe fëmijës përveç nëse këtë e kërkojnë arsye të veçanta të*

interesit publik. Në rastin konkret nuk kemi rrethana të veçanta të interesit publik dhe se një kërkesë e tillë është e pranueshme vetëm nga i adoptuari dhe jo nga prindërit e tij biologjik." Gjykata e Apelit, në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për interpretim të gabuar të nenit 194 të Ligjit për Familjen vuri theksin në përmbajtjen e paragrafit 2 të po këtij neni duke arsyetuar se sipas kësaj dispozite, të drejtë për të parashtruar kërkesë për njohjen e prindërve biologjikë ka vetëm i adoptuari i moshës madhore. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit konkludoi se Gjykata Themelore në bazë të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e të drejtës procedurale dhe asaj materiale.

35. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Supreme për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, respektivisht Aktgjykimit [AA.nr.178/2019] të 15 majit 2020, të Gjykatës së Apelit për shkak të: (i) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale; dhe (ii) shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPK-së, me kërkesën që: (i) të aprovohet padia e saj si e bazuar; (ii) të anulohet Aktvendimi, i 25 marsit 2016, i Komisionit për Ankesa të MPMS-së; dhe (iii) të detyrohet Departamenti i MPMS-së dhe Qendra për Punë Sociale të informojë fëmijën në lidhje me të drejtat e tij që rrjedhin nga neni 194, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen dhe nenit 18, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së.

36. Së pari, përkitazi me pretendimin e saj për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, parashtruesja e kërkesës duke iu referuar paragrafit 1 të nenit 194 të Ligjit për Familjen, thekson se: *"është detyrë e organit të kujdestarisë që përveç këshillave, të njoftojë dhe udhëzojë prindërit adoptues si dhe fëmijët e kësaj moshe se, posa fëmija të arrije moshën 18 vjeçare, ai e fiton të drejtën ligjore për të parë të dhënat e adoptimit, përfshirë këtu edhe të dhënat personale për prindërit biologjik*. Sipas saj *"pastaj është vetëm e drejtë ekskluzive e të birësuarit se, a dëshiron t'i njohë dhe të kontaktojë me prindërit biologjik, të tij"*.

37. Së dyti, parashtruesja kërkesës në kërkesën e saj iu referua edhe paragrafit 5 të nenit 22 të Konventës Evropiane për Adoptimin e Fëmijës, paragrafit 1 të nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, dhe nenit 8 të KEDNJ-së. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesja e kërkesës nuk ofroi arsyetim përkatës se si e mbështesin kërkesën e saj specifike dispozitat e nenit 22 të Konventës Evropiane për Adoptimin e Fëmijës dhe paragrafit 1 të nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, megjithatë në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së ajo iu referua praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), përkatësisht rasteve *Odièvre kundër*

Francës (Aktgjykim, i 13 shkurtit 2003); *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Aktgjykim, i 7 korrikut 1989]; *Mikulić kundër Kroacisë* (Aktgjykim, i 7 shkurtit 2002); *Jäägi kundër Zvicrës* (Aktgjykim, i 13 korrikut 2006) *dhe Phinikaridou kundër Qipros* (Aktgjykim, i 20 dhjetorit 2007). Në lidhje me këto të fundit, parashtruesja e kërkesës theksoi se: *"në të gjitha rastet e Gjykatës [GJEDNJ-së], e drejta e fëmijës, dhe e drejta e njohjes së origjinës, në një formë apo tjetrën prevalon mbi interesat e palëve të treta, dhe kur këto kanë nënshkruar paraprakisht klauzola të konfidencialitetit. Kjo nënkupton se në një interpretim vetanak të këtyre rasteve me situatën në fjalë, dhënë faktin që palët e vetme që kundërshtojnë dhënien e informatës fëmijës të tyre madhor në këtë rast janë prindërit adoptues, mund të vijnë në konkludim se: prindërit adoptues, nuk kanë të drejtë ta privojnë fëmijën e tyre të adoptuar nga vënia në dijeni, për të drejtat që i takojnë fëmijës në bazë të nenit 194 të Ligjit të Familjes së Kosovës, apo sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

38. Së treti, parashtruesja e kërkesës pretendoi se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është i përfshirë me mungesë të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në këtë kontekst, parashtruesja e kërkesës theksoi se Gjykata e Apelit ka aprovuar në tërësi qëndrimet e Gjykatës Themelore, mirëpo nuk ka adresuar pretendimet e saj ankimore të ngritura para kësaj gjykate.

39. Në fund, parashtruesja e kërkesës theksoi se ajo nuk ka kërkuar që ajo personalisht të ketë qasje ne dokumentacionin e adoptimit të fëmijës së saj biologjik, por ka kërkuar që fëmija i saj biologjik të njoftohet për faktin e adoptimit të tij, në mënyrë që ai të ketë të drejtë të vendos nëse dëshiron ta njoftojë nënën e tij biologjike.

40. Më 11 qershor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ-UZVP. nr. 37/2020] kërkesën e parashtrueses së kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e refuzoi si të pabazuar.

41. Gjykata Supreme vuri theks: (i) në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 194 të Ligjit për Familjen; dhe (ii) në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 17, dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 18 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së duke arsyetuar se Qendra për Punë Sociale është e obliguar të ruajë konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijës gjatë tërë procesit të adoptimit dhe pas tij.

42. Bazuar në si më sipër, Gjykata Supreme interpretoi dispozitat e lartcekura si në vijim: (i) në bazë të nenit 194 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit për Familjen faktet të cilat do të mundë të zbulonin ekzistimin dhe

rrethanat e adoptimit të fëmijës nuk guxojnë të zbulohen e as të hetohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe të fëmijës, përveç nëse kjo kërkohet për arsye të veçanta dhe për interesin publik. Me arritjen e moshës madhore, i adoptuari fiton të drejtën në qasje në të gjitha informatat lidhur me adoptimin e tij dhe me kërkesë të tij do t'i ofrohen informata personale për prindërit e tij biologjik; (ii) në bazë të nenit 17, paragrafit 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së, QPS-ja kompetente është e obliguar që të ruajë konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijës gjatë tërë procesit të adoptimit, dhe asnjë rrethanë nuk duhet të ofrojë dokumentacionin nga dosja e fëmijës, përjashtimisht personave zyrtar kompetent nga QPS, DPSF (MPMS) dhe gjykatës; (iii) bazuar në nenin 18 paragrafin 1 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së, përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë e informacioneve të mbledhura gjatë procesit të adoptimit, janë përgjegjës: Gjykata Themelore ku është bërë adoptimi dhe Organi i Kujdestarisë kompetent për mbrojtjen e fëmijës. Përderisa në paragrafin 2 të po këtij neni përcaktohet që i adoptuari në moshën madhore ka të drejtë në të gjitha informatat lidhur me adoptimin e tij dhe me kërkesë të tij do t'i ofrohen informata personale për prindërit e tij biologjikë.

43. Në kontekst të asaj si më sipër, Gjykata Supreme vlerësoi *" [...] gjegjësisht nëna biologjike e fëmiut të adoptuar nuk ka bazë ligjore që të informoj fëmiun e adoptuar për nënën e tij biologjike derisa fëmiu i adoptuar nuk të paraqesë kërkesë të shkruar për të njohur prindërit e tij biologjikë",* duke arsyetuar se kjo e drejtë i takon vetëm fëmijës së adoptuar.

44. Në vijim, Gjykata Supreme po ashtu konstatoi se: (i) të dhënat dhe rrethanat e adoptimit nuk duhet të zbulohen ose të hulumtohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe të fëmijës; dhe (ii) në rastin konkret nuk ekzistojnë *"interese të përfitimit publik dhe në kërkesë e tillë aprovohet vetëm nëse paraqitet nga i adoptuari dhe jo nga prindërit e tij biologjikë"*.

45. Përfundimisht, Gjykata Supreme duke adresuar edhe pretendimin e parashtrueses së kërkesës për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor konstatoi se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është i qartë dhe i kuptueshëm, përkatësisht i njëjti përmban arsyetim të mjaftueshëm në lidhje me faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, dhe përfundoi se në mënyrë të drejtë është zbatuar e drejta materiale dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtrueses së kërkesës.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

46. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi [ARJ-UZVP. nr. 37/2020] i 11 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 10 [pa titull] të DUDNJ-së; nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së, si dhe nenin 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

47. Parashtruesja e kërkesës fillimisht i referohet çështjes së zbatimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës sipas nenit 22 të Kushtetutës, gjegjësisht DUDNJ-në, KEDNJ dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

48. Në vijim, parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj i referohet paragrafit 2 të nenit 194 të Ligjit për Familjen, dhe neneve 1 dhe 12 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

49. Në lidhje me paragrafin 2 të nenit 194 të Ligjit për Familjen, parashtruesja e kërkesës i referohet "Komentarit të Ligji për Familjen" [autorë: *Haxhi Gashi, Abdullah Aliu dhe Adem Vokshi*, i publikuar në vitin 2012, faqe 144. Komentari në lidhje me paragrafin 2 të nenit 194 përmban si në vijim: *"Paragrafi 2 ka paraparë mundësinë që vetë fëmija i adoptuar pas arritjes së moshës madhore të ketë të drejtën në qasje ose ndryshe zbulimin e të dhënave lidhur me adoptimin. Ai mund të njihet me tërë procedurën e adoptimit, dokumentet apo të dhënat që lidhen me të dhe familjen adoptues, por edhe për të dhënat tjera të ndërlidhura me pjesëmarrësit e tjerë në procedurën e adoptimit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i paraparë në këtë paragraf është edhe e drejta e fëmijës për t'u njoftuar me të dhënat që kanë të bëjnë me familjen e tij biologjike. Pra, fëmijës i njihet edhe një e drejtë personale, por edhe natyrore që të ketë informata dhe të zbulojë se kush ishte familja e tij biologjike, respektivisht prindërit biologjik dhe të dhënat tjera në lidhje me prind biologjik"*.

50. Në kontekst të kësaj të fundit, parashtruesja e kërkesës thekson se: *"[...] në sistemin ligjor, qasja në të dhënat ne lidhje me adoptimin e tij vlen për fëmijën qe ka arritur moshën 18 vjeçare. Ne fakt, është detyre e organit të kujdestarisë që përveç këshillave, të njoftojë dhe udhëzojë prindërit adoptues si dhe fëmijët e kësaj moshe se, posa fëmija të arrijë moshën 18 vjeçare, ai e fiton të drejtën ligjore për të parë të dhënat e adoptimit duke përfshirë këtu edhe të dhënat personale për prindërit biologjik. Pastaj, është vetëm e drejtë*

ekskluzive e të birësuarit se, a dëshiron t'i njohe dhe te kontaktoje me prindërit biologjik, të tij".

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

51. Parashtruesja e kërkesës pretendimin e saj për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së e arsyeton me mungesë të arsyetimit të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme. Shkeljen e pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës e ndërlidh edhe me shkelje të nenit 10 të DUDNJ-së.

52. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesja e kërkesës thekon se kërkesa e saj e ngritur para instancave gjyqësore është keqkuptuar për arsye se ajo nuk ka kërkuar që ajo personalisht të ketë qasje në dokumentacionin e adoptimit të fëmijës së saj biologjik, por ka kërkuar që fëmija i saj biologjik të njoftohet për faktin e adoptimit të tij, në mënyre që ai të ketë të drejtë të vendos *"nëse dëshiron apo jo ta njoh nënën e tij biologjike"*. Në vijim, parashtruesja e kërkesës specifikon se kjo kërkesë themelore e paraqitur në padinë e saj para Gjykatës Themelore nuk është adresuar nga gjykatat e rregullta.

53. Në lidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës nënvizon se "*Gjykata Supreme nuk e ka trajtuar thelbin e kërkesës. Parashtruesja e kërkesës në asnjërën prej instancave te gjykatave te rregullta nuk ka pranuar përgjigjen në kërkesën e saj se pse E Paditura (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale/Komuna e Prishtinës) nuk ka kompetence qe te njoftoje fëmiun e saj biologjik se ai është i adoptuar dhe se ka te drejte qe ne baze te nenit 194 te Ligjit për Familjen te jete ne dijeni për nënën e tij biologjike. Asnjë e drejte, përfshi këtu edhe të drejtën e qasjes ne dokumentacionin e adoptimit nga fëmiu nuk mund te realizohet nëse ajo nuk është e njohur për shfrytëzuesin e saj potencial".*

54. Në vijim të kësaj, parashtruesja e kërkesës specifikon se: "*si rezultat [i keqkuptimit] kërkesës së [saj], asaj i është mohuar e drejta që të ketë një vendim te arsyetuar gjyqësor, sepse mos adresimi i kërkesave te parashtruara ne padi, vendimin gjyqësor e bënë të pa arsyetuar. Kjo për faktin se Vendimi gjyqësor duhet te adresoj kërkesat e palës ne procedure ne atë mënyrë qe nëse kërkesat e saja refuzohen ajo te jete ne dijeni për arsyet e këtij refuzimi. Vendimi gjyqësor i cili nuk trajton kërkesën themelore te padisë nuk mund ti ketë tiparet e një vendimi te arsyetuar gjyqësor, sepse ai edhe teorikisht nuk mund te jap arsye për faktet vendimtare".*

55. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesja nënvizon se parimi i arsyetimit të vendimeve gjyqësore është afirmuar edhe përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, dhe në lidhje me këtë i referohet rastit KI72/12 parashtrues i kërkesës *Veton Berisha*, Aktgjykim, i 17 dhjetorit 2012.

56. Në vijim, parashtruesja e kërkesës po ashtu thekson se gjykatat e rregullta asnjëherë nuk kanë dhënë arsye se pse nuk janë të zbatueshme dispozitat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së

57. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesja e kërkesës fillimisht i referohet dhe citon përmbajtjen e nenit 22, paragrafit 5 të Konventës për Adoptim dhe nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Sipas parashtrueses së kërkesës këto dispozita shprehin qartë *"rëndësinë e njohjes së origjinës dhe identitetit, dhe në mënyrën e përpilimit të tyre, konsiderojnë se e drejta për të njohur origjinën nënkuptohet" dhe më tej nënvizon se "praktika ndërkombëtare ka treguar se njohja e origjinës konsiderohet të jetë pjesë integrale e të drejtave që burojnë nga neni 8 i [KEDNJ-së]"*.

58. Arsyetimin e saj për pretendim të shkeljes së nenit 8 të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës e mbështet duke iu referuar edhe ofruar përmbledhje të shkurtër të rasteve të GJEDNJ, përkatësisht rasteve: *Odièvre kundër Francës* (Aktgjykim, i 13 shkurtit 2003*)*; *Anayo kundër Gjermanisë* (Aktgjykim, i 21 dhjetorit 2010); *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Aktgjykim, i 7 korrikut 1989)*; Mikulić kundër Kroacisë* (Aktgjykim, i 7 shkurtit 2002); *Jäägi kundër Zvicrës* (Aktgjykim, i 13 korrikut 2006]; dhe *Phinikaridou kundër Qipros* (Aktgjykim, i 20 dhjetorit 2007) duke dhënë edhe një përmbledhje të konstatimit të GJEDNJ-së në lidhje me këto raste.

59. Në vijim të kësaj, parashtruesja thekson se në të gjitha rastet e GJEDNJ-së *"e drejta e fëmijës, dhe e drejta e njohjes së origjinës, në një formë apo tjetrën prevalon mbi interesat e palëve të treta, edhe kur këto kanë nënshkruar paraprakisht klauzola te konfidencialitetit. Kjo nënkupton se, në një interpretim vetanak të këtyre rasteve me situatën në fjalë, dhënë faktin që palët e vetme që kundërshtojnë dhënien e informatës fëmijës të tyre madhor në këtë rast janë prindërit adoptues, mund të vijmë në konkludim se: prindërit adoptues, nuk kanë te drejte ta privojnë fëmijën e tyre të adaptuar nga vënia në dijeni, për të drejtat që i takojnë fëmijës në bazë të nenit*

194 të Ligjit të Familjes së Kosovës, apo sipas Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

60. Në fund, parashtruesja e kërkesës specifikon se *"[...] çfarëdo interesa tjerë që prindërit adaptues mund të kenë për mos-vënien në dijeni të fëmijës madhor, nuk kanë bazë ligjore të përmbahen nga ky informacion. Për më tepër, prindërit adoptues nuk mund të thirren në çfarëdo interesa personale apo emocionale duke tentuar t'i mbrojnë këto interesa, duke privuar fëmijën e tyre nga paraqitja e informatave thellësisht të rëndësishme të jetës dhe zhvillimit të fëmijës, të drejta te mbrojtura për origjinën dhe interesin e fëmijës, e të përcaktuara në instrumente të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare."* Në fund, parashtruesja e kërkesës i referohet edhe nenit 21 [Gjinia e Gjakut] të Ligjit për Familjen, duke theksuar se "*Kjo dispozitë ligjore me natyrë imperative dhe me pasoja penalo-juridike, mund të shkelet nëse fëmija biologjik i [saj] nuk vihet në dijeni se kush është nëna e tij biologjike".*

61. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) të shpallë kërkesën e saj të pranueshme; (ii) të konstatojë se Aktgjykimi [ARJ-UZVP. nr. 37/2020] i 11 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme është i përfshirë me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës ne lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 të KEDNJ-së; nenit 8 të KEDNJ-së; dhe nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [ARJ-UZVP.nr.37/2020] e 11 qershorit 2020, të Gjykatës Supreme, duke e kthyer rastin e saj në rivendosje në Gjykatën Supreme.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

3. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
4. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]"

Neni 36
[E Drejta e Privatësisë]

1. *Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.*
[...]

Neni 55
[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E Drejta për një proces të rregullt)

1.Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të

palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]"

Neni 8
(E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Neni 1

Në këtë Konventë, me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

Neni 2

1. Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

Neni 7

1. Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.

2. Shtetet Palë sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe me detyrimet që rrjedhin nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, sidomos në rastet kur, në mungesë të tyre, fëmija do të mbetej pa shtetësi.

Konventa e Këshillit të Evropës për Adoptimin e Fëmijëve [e hapur për nënshkrim me 27 tetor 2008 dhe hyrë në fuqi më 1 shtator 2011]

Neni 22 – Qasja dhe zbulimi i informatave

1 Mund të ndërmerren masa për të mundësuar që një birësim të kryhet pa zbuluar identitetin e birësuesit në familjen e origjinës së fëmijës.
2 Do të ndërmerren masa për të kërkuar ose lejuar që procedura e birësimit të zhvillohet privatisht.
3 Fëmija i birësuar do të ketë qasje në informatat e mbajtura nga autoritetet kompetente në lidhje me origjinën e tij ose të saj. Kur prindërit e tij ose të saj të origjinës kanë të drejtë ligjore të mos zbulojnë identitetin e tyre, do të mbetet e hapur për autoritetin kompetent, në masën e lejuar me ligj, për të përcaktuar nëse do të refuzojë atë të drejtë dhe do të zbulojë informacionin identifikues, duke pasur parasysh rrethanat dhe të drejtat përkatëse të fëmijës dhe prindërve të tij ose të saj të origjinës. Një fëmije të birësuar që nuk ka arritur moshën madhore mund t'i jepen udhëzimet e duhura.
4 Birësuesi dhe fëmija i birësuar do të jenë në gjendje të marrin një dokument i cili përmban ekstrakte nga regjistrat publikë që vërtetojnë datën dhe vendin e lindjes së fëmijës së birësuar, por që nuk zbulon shprehimisht faktin e birësimit ose identitetin e prindërve të tij ose të saj të origjinës Shtetet Palë mund të zgjedhin të mos e zbatojnë këtë dispozitë në format e tjera të birësimit të përmendura në nenin 11, paragrafi 4, të kësaj Konvente.
5 Duke pasur parasysh të drejtën e një personi për të ditur identitetin dhe origjinën e tij ose të saj, informatat përkatëse mblidhen dhe ruhen në lidhje me birësimin për të paktën 50 vjet pasi birësimi të bëhet përfundimtar.
6 Të dhënat publike mbahen dhe, në çdo rast, përmbajtja e tyre riprodhohet në atë mënyrë që të parandalojë personat që nuk kanë interes legjitim të mësojnë nëse një person është birësuar apo jo, dhe nëse ky informacion zbulohet, identiteti i prindërve të tij ose saj të origjinës.

Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës

Neni 21
Gjinia e gjakut

(1) Nuk mund të lidhin martesë personat në gjini të gjakut në vijë të drejtë, ose në vijë të tërthortë siç janë vëllau dhe motra prej një ati dhe një nëne, motra dhe vëllau prej atit ose nënës, xhaxhai dhe mbesa, daja dhe mbesa, tezja dhe nipi, as fëmijët e vëllezërve dhe motrave të një ati dhe nëne dhe fëmijët e vëllezërve dhe të motrave prej atit ose nënës;

(2) Kjo do të zbatohet edhe për vëllezërit dhe motrat prej një ati ose nënës, si dhe nëse marrëdhënia e tillë ka pushuar së ekzistuari për shkak të adoptimit.

(3) Gjinia e gjakut e bashkësisë jashtëmartesore është pengesë për martesë sikurse edhe ajo martesore.

9. Ndalimi i zbulimit dhe hetimeve

Neni 194
Parimet

(1) Të dhënat për adoptimin dhe rrethanat e tij nuk duhet të zbulohen ose hetohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe fëmijës përveç nëse këtë e kërkojnë arsye të veçanta të interesit publik.

(2) Në moshën madhore i adoptuari ka të drejtë në qasje në të gjitha informatat lidhur me adoptimin e tij dhe me kërkesë të tij do ti ofrohen informata personale për prindërit e tij biologjik.
[...]

11. Të drejtat dhe detyrimet e palës së adoptuar dhe adoptuesit

Neni 201.
Krijimi dhe përfundimi i marrëdhënieve familjare

(1) Me adoptim krijohen marrëdhënie familjare ndërmjet adoptuesit dhe personave në gjini në njërën anë, dhe ndërmjet të adoptuarit dhe pasardhësve të tij në anën tjetër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.
(2) Me themelimin e adoptimit shuhen të drejtat dhe detyrimet e të adoptuarit ndaj prindërve të tij dhe personave në gjini të tjerë në

familje si dhe të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe familjes ndaj tij.

Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare

Neni 1
[Dispozitat Themelore]

1.3. Përkufizimet

1.Këshillimi është një proces sistematik dhe i programuar i ofrimit të informacionit, këshillave dhe udhëzimeve me qëllim që të ndihmohet një individ ose një familje për të përmirësuar rrethanat sociale dhe ndër njerëzore.

Neni 12
[Shërbimet për të rriturit]

12.1. Në bashkëpunim me familjet, komunitetet, organizatat joqeveritare dhe organet tjera të parashikuara me ligj, komuna ofron përkujdesje sociale, këshillim dhe, në raste të veçanta, ndihmë materiale për njerëzit që kanë nevojë për shërbime sociale e që jetojnë në territorin e saj, duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave të tyre për shërbime të tilla dhe në mundësinë e komunës që t'i kryejë ato në mënyrë të arsyeshme.

Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr. 09/2014 për rregullimin e procedurave të adoptimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore

Neni 17
Pas themelimit të adoptimit

[...]

3. QPS-ja kompetente për fëmijën, është e obliguar që të ruaj konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijës gjatë tërë procesit të adoptimit dhe pasadoptimit; dhe në asnjë rrethanë nuk duhet të ofroj dokumentacion ose informacion nga dosja e fëmijës përjashtimisht personave zyrtar kompetente ne QPS, DPSF te MPMS-së dhe Gjykatë.

Neni 18
Dispozitat e tjera

1. *Për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë e informacioneve të mbledhura gjatë procesit të adoptimit, janë përgjegjës Gjykata themelore ku është bërë themelimi i adoptimit dhe Organi i Kujdestarisë kompetente për mbrojtjen e fëmijës.*

   2. Në moshën madhore i adoptuari ka të drejtë në qasje në të gjitha informatat lidhur me adoptimin e tij/saj dhe me kërkesë të tij/saj do t'i ofrohen informata personale për prindërit e tij/saj biologjik.

Dispozitat relevante ligjore të vendeve të tjera

Kodi i Familjes i Shqipërisë

Neni 262

I mituri, prindërit biologjike dhe birësuesit kane te drejtën e mirëbesimit për procesin dhe dokumentacionin e birësimit, si shprehje te respektimit te jetës private. Kur mosha dhe niveli i pjekurisë e lejojnë, i mituri ka te drejte te njihet me historinë e tij dhe, nëse është e mundur, me te dhënat për prindërit biologjike.

Ligji për Familjen i Kroacisë

Neni 142

(1) Qendra e mirëqenies mban dosjet e lëndëve dhe një regjistër të subjekteve të birësimit.
(2) Informacioni në lidhje me birësimin është një sekret zyrtar.
(3) Një fëmijë i birësuar i rritur, një prind adoptues dhe një prind që ka dhënë pëlqimin për birësimin e një fëmije në pajtim me nenin 129 paragrafi 2 të këtij ligji do të lejohet të inspektojë dosjet e subjekteve të birësimit dhe regjistrin e lindjeve të një të fëmije të adoptuar.
(4) Një fëmijë i birësuar i mitur do të lejohet nga një qendër e mirëqenies që të sheh dosjet e subjekteve në lidhje me birësimin, dhe një ofiqar në regjistrin e lindjeve të fëmijëve të birësuar, nëse qendra e mirëqenies përcakton që një shikim i dosjeve të birësimit dhe regjistrit të lindjeve është në interes të fëmijës.
(5) Të afërmve të ngushtë të gjakut të fëmijës së birësuar do t'u lejohet të shikojnë dosjet e subjekteve të birësimit nëse qendra e mirëqenies merr pëlqimin e një fëmije të rritur të adoptuar.
(6) Ministri kompetent për çështjet e mirëqenies do të përshkruajë mënyrën e mbajtjes së regjistrit dhe dosjeve të subjekteve të birësimit.

Kodi Civil i Gjermanisë

Neni 1751
Efekti i pëlqimit të prindërve, detyrimi i mbajtjes

(1) Me pëlqimin e njërit prind për birësim, kujdestaria prindërore e këtij prindi pezullohet; mundësia për të pasur kontakt personal me fëmijën mund të mos ushtrohet. Zyra e mirëqenies së të rinjve bëhet kujdestare; kjo nuk vlen nëse prindi tjetër ushtron kujdestarinë prindërore vetëm ose nëse tashmë është caktuar kujdestari. Kuratura ekzistuese nuk preket. Prindi birësues, gjatë kohës së kujdesit personal para birësimit, rregullohet me nenin 1688 (1) dhe (3) me modifikimet e nevojshme.
(2) Nënseksioni (1) nuk zbatohet për bashkëshortin, fëmija i të cilit është birësuar nga bashkëshorti tjetër.
(3) Kur pëlqimi i njërit prind ka pushuar së zbatuari, gjykata e familjes duhet të transferojë kujdestarinë prindërore tek prindërit nëse dhe në masën që kjo nuk bie ndesh me interesat më të mira të fëmijës.
(4) Prindi birësues ka për detyrim të paguajë mbajtjen para të afërmve të fëmijës sapo prindërit e fëmijës të kenë dhënë pëlqimin e nevojshëm dhe fëmija të jetë marrë nën kujdesin e prindit birësues me qëllim birësimi. Nëse një bashkëshort dëshiron të birësojë një fëmijë të bashkëshortit të tij, bashkëshortët kanë një detyrim ndaj fëmijës para të afërmve të tjerë të fëmijës që të paguajnë mbajtjen sapo të jetë dhënë pëlqimi i nevojshëm i prindërve të fëmijës dhe fëmija të jetë marrë në kujdesin e prindit birësues me qëllim birësimi.

Neni 1758
Ndalimi i zbulimit dhe marrjes në pyetje eksploruese

(1) Faktet që janë të përshtatshme për të zbuluar birësimin dhe rrethanat e tij mund të mos nxjerren në shesh ose zbulohen me anë të pyetjeve eksploruese pa miratimin e prindit birësues dhe të fëmijës, përveç nëse arsye të veçanta të interesit publik e bëjnë këtë të nevojshme.
(2) Nënseksioni (1) zbatohet me modifikimet e nevojshme nëse është dhënë pëlqimi sipas nenit 1747. Gjykata e familjes mund të urdhërojë që efektet e nënseksionit (1) të ndodhin nëse është bërë një kërkesë për zëvendësimin e pëlqimit të prindit.

Kodi Civil i Belgjikës

368-6. Autoritetet kompetente ruajnë informatat për origjinën e të birësuarit, përfshirë ato që kanë të bëjnë me identitetin e nënës dhe babait të tij, si dhe të dhënat e nevojshme për monitorimin e gjendjes shëndetësore të të birësuarit dhe për të kaluarën e familjes së tij, me

qëllim që t'i lejohet më vonë të të birësuarit, nëse dëshiron, të zbulojë origjinën e tij. Ato i sigurojnë të birësuarit ose përfaqësuesit të tij qasje në këto informata, me këshillat e duhura, deri në masën e lejuar sipas ligjit belg. Mbledhja, ruajtja dhe qasja në informata rregullohen me dekret mbretëror të miratuar në Këshillin e Ministrave.

Ligji për Familjen i Serbisë

Neni për regjistrimin dhe shikimin e regjistrit të lindjeve

326

(1) Aktvendimi për regjistrimin e ri të lindjes për të birësuarin i dërgohet pa vonesë nëpunësit të gjendjes civile që e mban regjistrin e lindjeve për fëmijën.
(2) Pas regjistrimit të ri të lindjes për të birësuarin, vetëm fëmija dhe birësuesit e fëmijës kanë të drejtë ta shikojnë regjistrin e lindjeve për fëmijën.
(3) Para se të lejohet fëmija të shikojë regjistrin e lindjeve, nëpunësi i gjendjes civile është i detyruar ta referojë fëmijën për këshillim psikosocial te autoriteti i kujdestarisë, shërbimi për këshillim familjar ose institucioni tjetër i specializuar për ndërmjetësimin e marrëdhënieve familjare.

Ligji për Familjen i Malit të Zi

Neni 143

Organi i kujdestarisë mban dokumentet e rasteve dhe procesverbalin e birësimit, si dhe shënimet dhe dokumentet për fëmijët e birësuar. Të dhënat e birësimit përbëjnë një sekret zyrtar. Një i birësuar i moshës madhore, birësuesi dhe prindi i fëmijës që ka dhënë pëlqimin për birësim do të kenë qasje në dokumentet e rastit. Organi i kujdestarisë i lejon një të birësuari të mitur qasje në dokumentet e një rasi nëse përcakton se kjo është në interesin e tij. Kushtet e hollësishme për mënyrën e mbajtjes së shënimeve dhe mirëmbajtjes së dokumenteve, përkatësisht dosjeve të rasteve, përcaktohen nga Ministria kompetente për mirëqenie sociale.

Neni 145

Përmes birësimit të plotë, të drejtat dhe detyrat reciproke të të birësuarve dhe të afërmve të tij/saj të gjakut pushojnë së ekzistuari, përveç nëse fëmija birësohet nga njerka ose njerku.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

62. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

63. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1.Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

64. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".

65. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenin 8 të KEDNJ-së, nenin 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

66. Në kontekst të këtyre pretendimeve, parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, e cila është një nga instrumentet ndërkombëtare, që sipas nenit 22 të Kushtetutës është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe *"[ka] prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike"*.

67. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton edhe praktikën e saj gjyqësore ku kishte theksuar se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të garantuara me instrumentet ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe janë pjesë e rendit juridik të Republikës së Kosovës (shih, në mes tjerash, rastin nr. KO162/18, parashtrues: *Kryetari i Kuvendit të Republikës* së *Kosovës,* Aktgjykim i 19 dhjetorit 2018, paragrafi 36 dhe KI207/19, parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë,* Aktgjykim, i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 107*)*.

68. Thënë këtë, Gjykata megjithatë duhet të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës mund të ngritë pretendime për shkeljen e nenit 7 të Konventës, apo më konkretisht nëse kjo dispozitë gjen zbatim në rastin e saj. Parashtruesja e kërkesës as në parashtresat e saj para gjykatave të rregullta dhe as në kërkesën e saj para kësaj Gjykate nuk ka specifikuar se si kjo dispozitë e kësaj Konvente gjen zbatim në rastin e saj, gjegjësisht nuk ka saktësuar se si kjo dispozitë mbështet kërkesën e saj për ta obliguar autoritetin publik, përkatësisht Qendrën për Punë Sociale që ta njoftojë fëmijën e saj biologjik se është i adoptuar.

69. Gjykata po ashtu i referohet nenit 1 të kësaj Konvente, i cili përcakton që: "*Në këtë Konventë, me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet"*. Në kuptim të kësaj të fundit, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës kërkesën e saj në Qendrën për Punë Sociale e kishte

parashtruar në vitin 2016, kur fëmija i saj biologjik kishte arritur moshën madhore.

70. Prandaj, duke marrë për bazë fushëveprimin e kësaj Konvente, Gjykata konsideron se në rastin konkret parashtruesja e kërkesës nuk mund të ngritë pretendime për shkelje të të drejtave të garantuara përmes dispozitave të kësaj Konvente për arsye se fëmija i saj biologjik, në momentin e parashtrimit të kërkesës së saj në Qendrën për Punë Sociale kishte arritur moshën madhore.

71. Përfundimisht, dhe duke iu rikthyer pretendimit të parashtrueses së kërkesës se gjykatat e rregullta kanë shkelur edhe nenin 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Gjykata konstaton se ky nen nuk gjen zbatim në rastin e saj.

72. Përderisa përkitazi me pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar e cila po ashtu konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ-UZVP. nr. 37/2020] e 11 qershorit 2020 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

73. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

74. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj përkitazi me pretendimet e parashtrueses së kërkesës se vendimet e gjykatave të rregullta, gjegjësisht Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me: (i) nenin 8 të KEDNJ-së; dhe (ii) nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Meritat e kërkesës

75. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës më 1 mars 2016 në Qendrën për Punë Sociale kishte parashtruar kërkesë, përmes së cilës kishte kërkuar që fëmija i saj biologjik, i moshës madhore, të cilin e kishte dhënë për birësim në vitin 1989 të njoftohet për ekzistimin e nënës së tij biologjike dhe interesimin e saj për ta njoftuar atë. Më 7 mars 2016, Qendra për Pune Sociale ishte përgjigjur se: (i) nuk ka bazë ligjore për të njoftuar fëmijën e saj biologjik në lidhje me birësimin e tij; dhe se (ii) qasje në informatë në lidhje me prindërit biologjikë ka vetëm fëmija i adoptuar i moshës madhore në bazë të kërkesës së tij/saj. Më 11 mars 2016, parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë për rishqyrtim të përgjigjes së 7 marsit 2016 të Qendrës për Punë Sociale në po këtë qendër. Më 17 mars 2016, Qendra për Punë Sociale, përmes shkresës së saj [05/55-141] kërkesën e parashtrueses së kërkesës e adresoi tek Departamenti i MPMS-së. Më 25 mars 2016, Komisioni për Ankesa i MPMS-së, përmes Aktvendimit [DPSF nr. 521] kërkesën e parashtrueses së kërkesës për rishqyrtim të përgjigjes së 11 marsit 2016 e refuzoi si të pabazuar. Për pasojë, më 29 prill 2016, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore. Si rezultat i padisë së saj, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.651/16] të 25 janarit 2019, padinë e parashtrueses së kërkesës e refuzoi si të pabazuar. Në vijim, si rezultat i ankesës së parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore nga parashtruesja e kërkesës, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.178/2019] të 15 majit 2020, ankesën e saj e refuzoi si të pabazuar. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Supreme për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, respektivisht Aktgjykimit [AA.nr.178/2019] të 15 majit 2020, të Gjykatës së Apelit për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPK-së, me kërkesën që: (i) të aprovohet padia e saj si e bazuar; (ii) të anulohet Aktvendimi, i 25 marsit 2016, i Komisionit për Ankesa të MPMS-së; dhe (iii) të detyrohet Departamenti i MPMS-së dhe Qendra për Punë Sociale të informojë fëmijën në lidhje me të drejtat e tij që rrjedhin nga neni 194, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen dhe neni 18, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ të MPMS-së. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ-UZVP.nr. 37/2020] të 11 qershorit 2020, kërkesën e parashtrueses së kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e refuzoi si të pabazuar.

76. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar theksoi se të dhënat dhe rrethanat e adoptimit nuk duhet të zbulohen ose të hulumtohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe të fëmijës, përveç nëse kjo kërkohet për arsye të veçanta dhe për arsye të interesit publik. Në vijim të kësaj, Gjykata konstatoi se në rrethanat e rastit konkret *"nuk ekzistojnë interese të përfitimit publik dhe një kërkesë e tillë aprovohet*

vetëm nëse paraqitet nga i adoptuari dhe jo nga prindërit e tij biologjikë".

77. Në kërkesën e saj në Gjykatë, parashtruesja e kërkesës i konteston konstatimet e lartcekura të Gjykatës Supreme, përfshirë edhe atyre të gjykatave të rregullta duke pretenduar: (i) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor; dhe (ii) shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së.

78. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës përgjatë zhvillimit të të gjitha procedurave pranë autoriteteve publike dhe atyre të gjykatave të rregullta, gjegjësisht në kërkesën për rishqyrtim të përgjigjes së Qendrës për Punë Sociale, kërkesëpadinë e saj në Gjykatën Themelore, në ankesën pranë Gjykatës së Apelit dhe kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor pranë Gjykatës Supreme kishte specifikuar se kërkesa e saj drejtuar Qendrës për Punë Sociale përmbante kërkesën specifike që fëmija i saj biologjik, i moshës madhore, të cilin e kishte dhënë për birësim në vitin 1989 të njoftohet: (i) në lidhje me ekzistimin e nënës së tij biologjike; dhe (ii) interesimin e saj për ta njoftuar atë. Këtë kërkesë, parashtruesja e kërkesës e kishte mbështetur në paragrafin 2 të nenit 194 të Ligjit për Familjen, duke interpretuar këtë dispozitë si obligim të organit përkatës që fëmija i saj biologjik duhet të informohet me të drejtën e tij që buron nga kjo dispozitë.

79. Thënë këtë, Gjykata vëren se kërkesa specifike e parashtrueses së kërkesës e dorëzuar në Gjykatë, përmban dy elemente, përkatësisht: (i) pretendimin që organi përkatës i kujdestarisë ka për obligim që të njoftojë fëmijën e saj biologjik për rrethanat e adoptimit të tij; dhe (ii) shprehjen e interesimit të saj për ta njoftuar fëmijën e saj biologjik. Megjithatë, Gjykata duke iu referuar elementit të dytë në kërkesën e saj, përmes së cilës ajo shpreh interesimin për ta njoftuar fëmijën e saj biologjik konsideron se parashtruesja e kërkesës duke kërkuar apo pretenduar që organi përgjegjës i kujdestarisë është i obliguar që të njoftojë fëmijën e saj biologjik për adoptimin e tij synon që të realizojë një të drejtë që ndërlidhet me aspektin e jetës së saj private.

80. Prandaj, në lidhje me pretendimet e lartcekura, Gjykata konsideron se thelbi i pretendimit të parashtrueses së kërkesës është se gjykatat e rregullta i kanë shkelur asaj të drejtën për jetë private të garantuar me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së duke mos i miratuar asaj kërkesën e saj për njoftimin e fëmijës së saj biologjik në lidhje me ekzistimin e nënës së tij biologjike dhe interesimin e parashtrueses së kërkesës për ta njoftuar atë.

Pretendimi i parashtrueses së kërkesës në ndërlidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, i cili ngërthen aspekte të drejtës së saj në jetë private është i garantuar edhe me paragrafin 1 të nenit 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës.

81. Prandaj, pretendimet e lartcekura të parashtrueses së kërkesës përkitazi me nenin 36 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, përfshirë edhe pretendimin përkitazi me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

82. Rrjedhimisht, dhe në vijim Gjykata: (i) do të shqyrtojë pretendimin thelbësor të parashtrueses së kërkesës përkitazi me nenin 36 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së; për të vazhduar me (ii) adresimin e pretendimit të parashtrueses së kërkesës përkitazi me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

I. Përkitazi me pretendimin për nenin 36, paragrafin 1 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së

83. Në këtë aspekt dhe me qëllim të trajtimit të pretendimeve thelbësore të parashtrueses së kërkesës për respektim të jetës private, Gjykata së pari do të elaborojë: (i) parimet e përgjithshme të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, në mënyrë që të vlerësohet aplikueshmëria e këtyre neneve në rrethanat e rastit të parashtrueses së kërkesës, për të vazhduar me aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret.

A. Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare

84. Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës, që përcakton se *"Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera"*.

85. Paragrafi 1 i nenit 8 të KEDNJ-së përcakton që "*Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij*".

86. Gjykata fillimisht thekson se ndonëse fushëveprimi i nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, nuk është i pakufizuar, GJEDNJ

e ka përkufizuar fushëveprimin e nenit 8 të KEDNJ-së, në mënyrë të gjerë kur një e drejtë specifike nuk është specifikisht e theksuar në këtë nen (shih në lidhje me këtë rastin e Gjykatës, KI56/18, parashtrues *Ahmet Frangu*, Aktgjykim, i 22 korrikut 2020, paragrafi 83). Qëllimi parësor i nenit 8 të KEDNJ-së, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, është që të mbrojë individët nga "ndërhyrjet" arbitrare në jetën e tyre: (i) private; (ii) familjare; (iii) të vendbanimit; ose (iv) të korrespondencës (shih, në këtë kontekst e ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *P. dhe S. kundër Polonisë*, Aktgjykim i 30 tetorit 2012, paragrafi 94; dhe *Nunez kundër Norvegjisë,* Aktgjykim i 28 qershorit 2011, paragrafi 68, po ashtu shih rastin e Gjykatës KI56/18, parashtrues *Ahmet Frangu* , të cituar më lart, paragrafi 83). Të drejtat e garantuara bazuar në sistemin e KEDNJ-së dhe praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së, sigurohen përmes: (i) detyrimeve negative, përkatësisht detyrimit të shtetit për të mos "ndërhyrë" në jetën private dhe familjare (shih, në këtë kontekst rastet e GJEDNJ-së *Libert kundër Francës*, Aktgjykim, i 22 shkurtit 2018, paragrafët 40-42; dhe *Kroon dhe të tjerët kundër Holandës*, Aktgjykim, i 27 tetorit 1994, paragrafi 31); dhe (ii) detyrimeve pozitive, përkatësisht detyrimit të shtetit për t'u siguruar që këto të drejta të gëzohen në mënyrë efektive (shih rastet e GEJNDJ-së *Lozovyye kundër Rusisë*, Aktgjykim, i 24 prillit 2018, paragrafi 36 dhe *Evans kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], Aktgjykim, i 10 prillit 2007, paragrafi 75).

87. Rrjedhimisht, individët që pretendojnë shkelje të nenit 36 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së duhet të tregojnë që kërkesa e tyre bie në së paku njërën nga katër kategoritë e interesave që mbrohen nga këto dy dispozita, përkatësisht e drejta për: (i) jetë private; (ii) jetë familjare; (iii) vendbanim; dhe (iv) korrespondencë (shih rastin e Gjykatës KI56/18, të cituar më lart, paragrafi 83).

88. Thënë këtë, në trajtimin e pretendimeve që ndërlidhen me shkelje të së drejtës në jetën private, GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore fillimisht përcakton nëse kërkesa e parashtruesit përkatës bie nën fushëveprimin e nenin 8 të KEDNJ-së, ose më saktësisht, nëse ky nen është i aplikueshëm në rrethanat e atij rasti. Pasi të jetë konstatuar aplikueshmëria e nenit 8 të KEDNJ-së në rrethanat e rastit përkatës, GJEDNJ vazhdon me shqyrtimin e mëtutjeshëm të një pretendimi të paraqitur mbi bazën e nenin 8 të KEDNJ-së. Ky qëndrim dhe konstatim, i vendosur përmes praktikës së GJEDNJ-së është afirmuar edhe në praktikën gjyqësore të vet Gjykatës, respektivisht në rastin e lartcekur KI56/18, parashtrues *Ahmet Frangu* paragrafët 90-99 të Aktgjykimit).

89. Së dyti, GJEDNJ vlerëson nëse rasti duhet të trajtohet nga këndvështrimi i detyrimit negativ apo pozitiv të shtetit, përkundër faktit që jo gjithmonë është lehtësisht dhe qartësisht i dukshëm dallimi në mes të këtyre detyrimeve. Megjithatë, sipas GJEDNJ-së, në parim është e rëndësishme të vlerësohet nëse shteti ka vepruar, përkatësisht ndërhyrë, apo shteti ka dështuar të veprojë, më saktësisht nëse shteti përkatës ka dështuar që përmes sistemit të tij ligjor ose administrativ të sigurojë të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare në rrethanat e këtij rasti (shih rastin e GJEDNJ-së *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 41).

90. Prandaj, Gjykata, duke u bazuar në parimet e lartcekura përkitazi me nenin 8 të KEDNJ-së, rithekson se do të trajtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës duke e aplikuar mbi këtë vlerësim praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së. Gjykata, rrjedhimisht, së pari do të trajtojë, çështjen e aplikueshmërisë së nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së për sa i përket çështjeve konkrete të këtij rasti, respektivisht, refuzimit të kërkesës së parashtrueses së kërkesës nga ana e autoriteteve publike, duke filluar nga Qendra për Punë Sociale që ta njoftojë fëmijën e saj të moshës madhore përkitazi me ekzistimin e nënës së tij biologjike dhe interesimin e saj për ta njoftuar atë. Pas përcaktimit të aplikueshmërisë së paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës dhe paragrafit 1, të nenit 8 të KEDNJ-së, Gjykata më tutje, do të shqyrtojë dhe përcaktojë nëse kërkesa duhet trajtuar nga këndvështrimi i detyrimit negativ apo pozitiv të Republikës së Kosovës. Në rast se duhet të trajtohet nga këndvështrimi i detyrimit negativ, ajo do të vlerësojë nëse ka pasur "ndërhyrje" në të drejtat e parashtrueses së kërkesës dhe nëse "ndërhyrja" e tillë: (i) ka qenë "në përputhje me ligjin" ose "e përcaktuar me ligj"; (ii) ka "ndjekur një qëllim legjitim"; dhe (iii) ka "qenë e domosdoshme në një shoqëri demokratike." Ndërsa, në rast se çështja specifike duhet të trajtohet nga këndvështrimi i detyrimit pozitiv, Gjykata do të ekzaminojë nëse, në rrethanat e rastit konkret, shteti ka pasur detyrim të ndërmarrë masa përmes së cilave do të sigurohej realizimi efektiv i të drejtës së parashtrueses së kërkesës për një jetë private, siç është garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së.

B. Aplikueshmëria e nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së në rrethanat e rastit konkret

91. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rithekson se e drejta për jetë private është e përfshirë në: (i) paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës, i cili nen shprehimisht përcakton se: *"Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private [...]"* ; dhe, siç është cekur më lart, (ii)

paragrafin 1 të nenit 8 të KEDNJ-së, dhe i cili shprehimisht përcakton se "*Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private [...]*".

92. Në kuadër të kësaj të drejte, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ngërthen edhe rastet që ndërlidhen me marrëdhënien midis prindërve biologjikë dhe fëmijëve.

93. Në vijim të kësaj, Gjykata po ashtu vëren se GJEDNJ testin e aplikueshmërisë së nenit 8 në mënyrë të detajuar e ka zhvilluar përmes praktikës së saj gjyqësore që i referohen rasteve të caktimit të atësisë apo kërkesave të fëmijëve, të dhënë për adoptim që kanë kërkuar të dhëna në lidhje me prindërit e tyre biologjikë.

94. Megjithatë, marrë për bazë rrethanat faktike të rastit të parashtrueses së kërkesës në rastin konkret, Gjykata gjatë analizës dhe shqyrtimit të saj nëse neni 36 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së janë të aplikueshëm në rastin e saj, në mënyrë specifike do t'i referohet rastit të GJEDNJ-së *I.S. kundër Gjermanisë* (Aktgjykim, i 13 tetorit 2014), në të cilin rast GJENJ kishte përcaktuar dhe konstatuar se marrëdhënia e nënës biologjike më fëmijët e saj të adoptuar bie nën fushëveprimin e nenit 8 të KEDNJ-së. Gjykata, me qëllim të aplikimit të konstatimeve të saj përkitazi me aplikueshmërinë e nenit 8 të KEDNJ-së, në rastin *I.S. kundër Gjermanisë* për aq sa janë të aplikueshme në rrethanat e parashtrueses së kërkesës fillimisht do të përmbledhë shkurtimisht rrethanat faktike të këtij rasti të GJEDNJ-së dhe parimet e aplikuara nga kjo e fundit në rastin konkret që kanë rezultuar në konstatimin e saj për aplikueshmërinë e nenit 8, paragrafit 1 të KEDNJ-së në këtë rast.

95. Rrethanat e rastit të GJEDNJ-së *I.S. kundër Gjermanisë* ndërlidhen me atë se parashtruesja e kërkesës ishte ankuar se nuk i ishte mundësuar që të kishte kontakt të rregullt dhe të pranojë informata për fëmijët e saj biologjikë të moshës minore, të cilët ishin adoptuar nga një çift tjetër. Ajo kishte pretenduar se vendimi i gjykatave të rregullta të Gjermanisë përkitazi me kontaktin dhe informatat për fëmijët e saj biologjikë i kishin cenuar asaj të drejtat e garantuara me nenin 8 të KEDNJ-së. Në kërkesën e saj, ajo në veçanti pretendoi se asaj i ishte premtuar një *"adoptim gjysme i hapur, duke i dhënë të drejtë asaj që të këtë kontakt me fëmijët e saj, i cili nuk ishte respektuar"*. GJEDNJ fillimisht kishte theksuar se kërkesa në rastin *I.S. kundër Gjermanisë* ekskluzivisht ka të bëjë me refuzimin e gjykatave vendore për t'i dhënë parashtrueses qasje dhe informacion rreth fëmijëve të saj biologjikë. GJEDNJ, në lidhje me këtë rikujtoi se parashtruesja, në fakt nuk e kishte kontestuar vlefshmërinë e pëlqimit të saj për t'i vendosur fëmijët e saj të sapolindur për adoptim (paragrafi 67, i Aktgjykimit).

96. Në vijim, GJEDNJ, konsideroi se marrëdhënia e parashtrueses së kërkesës me fëmijët e saj binte nën mbrojtjen e nenit 8 të KEDNJ-së, në kuadër të nocionit të "jetës familjare", vetëm në kohën kur kishin lindur fëmijët e saj biologjikë. Sipas GJEDNJ-së "*Marrëdhënia midis parashtrueses dhe fëmijëve mund të ketë pushuar së rëni brenda fushëveprimit të "jetës familjare" në momentin kur parashtruesja kishte nënshkruar pëlqimin e saj për t'i vendosur fëmijët për birësim*" (paragrafi 67, i Aktgjykimit).

97. Tutje, GJEDNJ duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore vazhdoi me arsyetimin se "*lidhja familjare biologjike midis një prindi biologjik dhe një fëmije, në vetvete, pa asnjë element të mëtutjeshëm ligjor apo faktik që tregojnë ekzistencën e një marrëdhënieje të ngushtë personale, mund të jetë e pamjaftueshme për të kërkuar mbrojtjen e nenit 8*" (paragrafi 68, i Aktgjykimit, në lidhje me këtë shih referencat e përdorura të GJEDNJ në rastet *Schneider kundër Gjermanisë*, Aktgjykim, i 15 shtatorit 2011, paragrafi 80, dhe *Hülsmann kundër Gjermanisë*, Vendim përkitazi me pranueshmërinë, i 18 marsit 2008). GJEDNJ tutje theksoi se "pavarësisht se Gjykata ka konsideruar në disa raste se edhe "jeta familjare e synuar" mund të bjerë, në rrethana të jashtëzakonshme, brenda kufijve të nenit 8, GJEDNJ gjeti se në rastin *I.S. kundër Gjermanisë*, lidhja familjare ekzistuese ishte ashpërsuar me dashje nga parashtruesja e kërkesës (paragrafi 69, i Aktgjykimit).

98. GJEDNJ megjithatë vazhdoi me vlerësimin duke konstatuar se përcaktimi i të drejtave të tjera ekzistuese apo të sapokrijuara midis parashtrueses së kërkesës, prindërve adoptues dhe fëmijëve biologjikë, edhe pse bien jashtë fushëveprimit të "jetës familjare", i përkasin një pjese të rëndësishme të identitetit të parashtrueses së kërkesës si nënë biologjike dhe "jetës së saj private" në kuptim të nenit 8, paragrafit 1 të KEDNJ-së (paragrafi 69, i Aktgjykimit). Këtë konstatim GJEDNJ e kishte mbështetur edhe në praktikën e saj të mëparshme gjyqësore, përkatësisht në rastet *Schneider kundër Gjermanisë* dhe *Anayo kundër Gjermanisë*. Gjykata vëren se GJEDNJ në këto dy raste, në mënyrë të ngjashme kishte konstatuar se lidhja familjare e synuar nga prindërit apo fëmijët biologjikë nuk bien në fushëveprimin e "jetës familjare" në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së, megjithatë, një marrëdhënie e tillë e synuar i përket një pjese të rëndësishme të identitetit të parashtruesit/es të kërkesës dhe jetës së tij/saj private në kuptim të nenit 8, paragrafit 1 të KEDNJ-së (shih rastet e sipërcekura të GJEDNJ-së *Anayo kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 62, dhe *Schneider kundër Gjermanisë*, të cituar më lart, paragrafi 90).

99. Bazuar në të lartcekurat, në veçanti konstatimin e GJEDNJ-së në lidhje me aplikueshmërinë e nenit 8 në rast të ngjashëm, si ai i parashtrueses së kërkesës, e që ndërlidhet me marrëdhënien e synuar të nënës biologjike me fëmijën e saj, Gjykata duke e aplikuar arsyetimin e dhënë në këtë konstatim të GJEDNJ-së konsideron se në rastin e parashtrueses së kërkesës mbrojtja e nenit 36 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së në kuadër të nocionit të së drejtës familjare po ashtu ka pushur në momentin kur parashtruesja e kërkesës kishte dhënë pëlqimin për adoptimin e fëmijës së saj në vitin 1989. Çështja e pëlqimit të parashtrueses së kërkesës nuk ishte e kontestueshme as në kërkesën e saj të parashtruar në Qendrën për Punë Sociale ashtu edhe në kërkesëpaditë dhe ankesat e saj para gjykatave të rregullta. Thënë këtë, Gjykata konstaton se neni 36 i Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së në kuptim të nocionit për të "drejtë familjare "nuk mund të jetë i aplikueshëm në rastin e saj për arsye se kërkesa bie jashtë fushëveprimit të këtij nocioni.

100. Megjithatë, Gjykata duke aplikuar qëndrimin dhe konstatimin e GJEDNJ-së përmes praktikës së saj gjyqësore në rastet e sipërcituara, konsideron se kërkesa e parashtrueses së kërkesës, përmes së cilës kishte shprehur interesimin e saj për ta njoftuar fëmijën e saj të dhënë për adoptim në vitin 1989 ngërthen elemente që i përkasin një pjese të rëndësishme të identitetit të saj si nënë biologjike dhe të cilat afektojnë të drejtën e saj për jetë private në kuptim të nocionit të "jetës së saj private" të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së. Thënë këtë, Gjykata duke u bazuar në rrethanat faktike dhe juridike të kërkesës së parashtrueses së kërkesës vlerëson se kërkesa e saj hyn në fushëveprimin e paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së në kuptim të nocionit të "jetës private" dhe rrjedhimisht konstaton se të njëjtat janë të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret.

101. Si rezultat i konstatimit të saj se neni 36 i Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së janë të aplikueshme në rrethanat e parashtrueses së kërkesës, Gjykata në vijim do të vlerësojë nëse vendimi i autoriteteve publike, përkatësisht vendimi i Qendrës për Punë Sociale dhe aktgjykimet e gjykatave të rregullta për ta refuzuar kërkesën e saj për njoftimin e fëmijës së saj të dhënë për adoptim dhe shprehjen e interesimit të saj për ta njoftuar fëmijën e saj është në përputhshmëri ose jo me të drejtat e garantuara përmes neneve të lartcekura. Thënë këtë, dhe siç është sqaruar më lart, paraprakisht, Gjykata duhet të vlerësojë, nëse rrethanat e rastit konkret, duhet të vlerësohen nga këndvështrimi i detyrimit negativ apo pozitiv të Republikës së Kosovës.

102. Në kuptim të saj nëse rasti duhet të trajtohet nga këndvështrimi i detyrimit negativ i shtetit, Gjykata vëren se kriteret mbi bazën e të cilave shteti mund të ndërhyjë në realizmin e të drejtave të lartcekura në kuptim të paragrafit 1 të nenit 8 të KEDNJ-së janë të përcaktuara ne paragrafin 2 të po këtij neni i cili përcakton që: *"Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve."* Në bazë të kësaj rezulton që kufizimi apo ndërhyrja e shtetit është e lejuar nëse "është në përputhje me ligjin" ose e "përcaktuar me ligj" dhe nëse është e "domosdoshme në një shoqëri demokratike" me qëllim të mbrojtjes së njërës nga qëllimet e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 8 të KEDNJ-së.

103. Në vijim, Gjykata po ashtu rikujton se përgjatë procedurës së zhvilluar gjyqësore, si parashtruesja e kërkesës po ashtu edhe gjykatat e rregullta i janë referuar nenit 22 të Konventës së Këshillit të Evropës për Adoptim. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata thekson se ky instrument ndërkombëtar nuk është i zbatueshëm në Republikën e Kosovës, për arsye se Republika e Kosovës nuk është palë nënshkruese e kësaj konvente. Megjithatë, Gjykata vëren se dispozitat e kësaj Konvente janë të mishëruara në legjislacionin përkatës të Republikës së Kosovës, që i referohen procedurave të adoptimit.

104. Në lidhje me këtë, Gjykata duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së vëren se neni 22 i Konventës për Adoptim ishte interpretuar dhe aplikuar edhe përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (në lidhje me aplikimin e nenit 22 të Konventës për Adoptim, të vitit 2008 shih rastin *I.S. kundër Gjermanisë,* të cituar më lart, paragrafi 76).

105. Në kontekst të kësaj, Gjykata rithekson se sipas nenit 53 të Kushtetutës, gjykatat e Republikës së Kosovës, të gjitha pa përjashtim, e kanë për obligim që të interpretojnë *"Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me këtë Kushtetutë sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*. Kjo do të thotë që, në të gjitha instancat kur Gjykata Kushtetuese ose gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës i interpretojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë, standardet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të zbatohen për këto të drejta dhe liri, kur kjo është e zbatueshme. Në rast konflikti midis të dyjave, standardet e vendosura nga GJEDNJ në interpretimin e KEDNJ-së do të mbizotërojnë (shih rastin e Gjykatës KI207/19, të cituar më lart, paragrafi 109*)*.

106. Rrjedhimisht, dhe bazuar në të lartcekurat, Gjykata në vijim gjatë vlerësimit të parimeve të vendosura nga GJEDNJ në rastet e ngjashme dhe aplikimin e tyre në rrethanat e rastit konkret do t'i referohet dhe do e marrë për bazë edhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në ato raste kur është interpretuar edhe neni 22 i Konventës për Adoptim.

107. Në vijim të kësaj, dhe ashtu siç është theksuar më lart, Gjykata rikujton se kërkesa specifike e parashtresës së kërkesës e dorëzuar në Gjykatë, ngërthen në vete dy elemente, përkatësisht: (i) kërkesën apo pohimin e parashtrueses së kërkesës që organi përkatës i kujdestarisë ka për obligim që të njoftojë fëmijën e adoptuar për rrethanat e adoptimit të tij; dhe (ii) shprehjen e interesimit të saj për ta njoftuar fëmijën e saj biologjik. Në lidhje me të parën, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës i ka interpretuar dispozitat relevante në fuqi të ligjit vendor, përkatësisht paragrafin 2 të nenit 194 të Ligjit për Familjen duke pretenduar se obligimi i organit përkatës të kujdestarisë për ta njoftuar fëmijën e saj biologjik se është i adoptuar rrjedh nga kjo dispozitë. Në vijim, Gjykata duke iu referuar elementit të dytë të kërkesës së saj, përkatësisht shprehjen e interesimit të saj për ta njoftuar fëmijën e saj biologjik konsideron se parashtruesja e kërkesës duke kërkuar apo pretenduar që organi përgjegjës i kujdestarisë është i obliguar që të njoftojë fëmijën e saj biologjik për adoptimin e tij synon që të realizojë një të drejtë të saj që ndërlidhet me aspektin e jetës së saj private, gjegjësisht njoftimin me fëmijën e saj biologjik.

108. Gjykata fillimisht rikujton edhe pretendimin specifik të parashtrueses së kërkesës, ku thekson se në të gjitha rastet e GJEDNJ-së *"e drejta e fëmijës, dhe e drejta e njohjes së origjinës, në një formë apo tjetrën prevalon mbi interesat e palëve të treta, edhe kur këto kanë nënshkruar paraprakisht klauzola te konfidencialitetit. Kjo nënkupton se, në një interpretim vetanak të këtyre rasteve me situatën në fjalë, dhënë faktin që palët e vetme që kundërshtojnë dhënien e informatës fëmijës të tyre madhor në këtë rast janë prindërit adoptues, mund të vijmë në konkludim se: prindërit adoptues, nuk kanë te drejte ta privojnë fëmijën e tyre të adaptuar nga vënia në dijeni, për të drejtat* që i takojnë fëmijës *në bazë të nenit* 194 *të Ligjit të Familjes së Kosovës, apo sipas Nenit* 8 *të Konventës Evropiane për te Drejtat e Njeriut".*

109. Në lidhje me këtë, parashtruesja pretendimin e saj të lartcekur e mbështet duke iu referuar dhe ofruar përmbledhje të shkurtër të rasteve të GJEDNJ-së në kërkesën e saj, përkatësisht rasteve: *Odièvre kundër Francës* (Aktgjykim, i 13 shkurtit 2003*)*; *Anayo kundër Gjermanisë* (Aktgjykim, i 21 dhjetorit 2010); *Mikulić kundër Kroacisë*

[Aktgjykim, i 7 shkurtit 2002]; dhe *Phinikaridou kundër Qipros* (Aktgjykim, i 20 dhjetorit 2007). Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës kërkesëpadinë, ankesën dhe kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, respektivisht para gjykatave të rregullta e kishte mbështetur, ndër tjerash, edhe në rastet e lartcekura të GJEDNJ-së.

110. Me qëllim të vlerësimit nëse rastet e referuara nga parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj ndërlidhen me rrethana të ngjashme faktike si në rastin e saj dhe nëse konstatimet dhe qëndrimet e GJENDJ-së mund të aplikohen në rastin konkret, Gjykata në vijim do të prezantojë një përmbledhje të këtyre rasteve të lartcekur përkatësisht rrethanave faktike dhe konstatimin e GJEDNJ-së, të dhënë në rastet: *Odièvre kundër Francës; Anayo kundër Gjermanisë; Mikulić kundër Kroacisë;* dhe *Phinikaridou kundër Qipros*.

111. Rrethanat e rastit *Odièvre kundër Francës* ndërlidheshin me atë se parashtruesja e kërkesës ishte braktisur nga nëna e saj biologjike pas lindjes dhe ishte lënë në Departamentin e Shëndetit dhe Sigurimit Social. Nëna e saj biologjike në bazë të legjislacionit në fuqi në atë kohë kishte kërkuar që edhe pas procedurës së adoptimit identiteti i saj të mbahej sekret. Parashtruesja e kërkesës, në ndërkohe ishte adoptuar në bazë të një urdhri të plotë birësimi, dhe pas një periudhe të caktuar kishte parashtruar kërkesë për zbulimin e identitetit të prindërve biologjikë, e cila kërkesë ishte refuzuar nga autoritetet franceze me arsyetimin se ajo kishte lindur nën një procedurë të veçantë e cila në atë kohë i lejonte nënat të mbeteshin anonime. Në rastin konkret, GJEDNJ konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private), duke vlerësuar në veçanti se parashtrueses së kërkesës i ishte dhënë qasje në informacione jo-identifikuese për nënën dhe familjen e saj biologjike që i mundësonin asaj të gjurmojë disa nga rrënjët e saj, duke siguruar mbrojtjen e interesave të palëve të treta. Përveç kësaj, legjislacioni i fundit i miratuar në Francë, në vitin 2002 kishte lejuar heqjen dorë nga konfidencialiteti dhe për pasojë ishin përcaktuar procedura që lehtësonin kërkimin për familjen biologjike të fëmijëve të adoptuar. Për pasojë, sipas GJEDNJ-së, parashtrueses së kërkesës bazuar në këtë ligj të ndryshuar i ishte mundësuar zbulimi i identitetit të nënës së saj biologjike, me kusht që të merrte pëlqimin e kësaj të fundit për të siguruar që nevoja e nënës për mbrojtje dhe kërkesa legjitime e parashtrueses së kërkesës të jenë në pajtim me njëra tjetrën, në mënyrë që të sigurohet një ekuilibër i drejtë dhe proporcion i mjaftueshëm midis interesave konkurruese.

112. Rrethanat e rastit *Anayo kundër Gjermanisë* ndërlidheshin me refuzimin e gjykatave gjermane për ta lejuar parashtruesin e kërkesës,

si baba biologjik që të takohet me fëmijët e tij binjakë me të cilët ai kur nuk kishte jetuar më parë. Fëmijët e tij biologjikë jetonin me nënën dhe bashkëshortin e saj. GJEDNJ konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së. GJEDNJ gjeti se ndërhyrja e autoriteteve gjermane në të drejtën e parashtruesit të kërkesës, të garantuar me nenin 8 të KEDNJ-së nuk ishte "e domosdoshme në një shoqëri demokratike", përkatësisht autoritetet vendore nuk e kishin shqyrtuar çështjen nëse një marrëdhënie midis parashtruesit të kërkesës dhe fëmijëve të tij biologjikë do të ishte në interes të këtyre të fundit.

113. Rrethanat e rastit *Mikulić kundër Kroacisë* ndërlidhen me një fëmijë të lindur jashtë martesës i cili, së bashku me nënën e saj kishin parashtruar padi për njohjen e atësisë. Parashtruesja e kërkesës u ankua se ligji kroat nuk i detyronte meshkujt ndaj të cilëve ishin ngritur paditë për njohje të atësisë t'i respektojnë urdhrat e gjykatës për t'iu nënshtruar testeve të ADN-së, dhe se dështimi i gjykatave vendore për të vendosur për kërkesën e saj për njohjen e atësisë e kishte lënë atë të pasigurt sa i përket identitetit të saj personal. GJEDNJ gjeti shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së. GJEDNJ vërejti në veçanti se, në vendosjen e një kërkese për përcaktimin e atësisë, gjykatave u kërkohej të kishin parasysh parimin bazë të interesave të fëmijës. Në rastin konkret, GJEDNJ konstatoi se përgjatë procedurave të ndjekura nuk ishte arritur një ekuilibër i drejtë midis së drejtës së parashtrueses së kërkesës për të eliminuar pasigurinë e saj lidhur me identitetin e saj personal pa vonesa të panevojshme dhe atë të babait të saj të supozuar për të mos iu nënshtruar testeve të ADN -së. Prandaj, joefikasiteti i gjykatave e kishte lënë parashtruesen e kërkesës në një gjendje të pasigurisë së tejzgjatur në lidhje me identitetin e saj personal.

114. Ndërsa në lidhje me rastin *Phinikaridou kundër Qipros* rrethanat e këtij rasti ndërlidhen me atë se në vitin 1991, Qeveria e Qipros kishte miratuar legjislacionin që u mundësonte fëmijëve të lindur jashtë martesës të kërkojnë njohjen gjyqësore të atësisë. Periudha e kufizimit për një kërkesë nga fëmija sipas këtij ligji ishte tri vjet nga data kur fëmija arrin moshën madhore ose, në rastin e fëmijëve që tashmë kishin arritur moshën madhore, tri vjet nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit. Parashtruesja e kërkesës, e cila në ditën e hyrjes në fuqi të ligjit kishte arritur moshën madhore, nuk e kishte mësuar identitetin e babait të saj biologjik deri në dhjetor 1997. Në qershor 1999 ajo kishte paraqitur një kërkesë në gjykatën e familjes për njohjen gjyqësore të atësisë. Megjithatë, kjo u hodh poshtë me arsyetimin se periudha e parashkrimit e zbatueshme në rastin e saj kishte skaduar më 1 nëntor 1994, tri vjet pasi ligji kishte hyrë në fuqi. GJEDNJ konsideroi se duhej të përcaktohej nëse shteti kishte respektuar detyrimet e tij pozitive në

trajtimin e padisë së parashtrueses për njohjen gjyqësore të atësisë. Pra, çështja ishte nëse natyra e afatit dhe/ose mënyra në të cilën u aplikua ishte në përputhje me KEDNJ dhe nëse ishte arritur një ekuilibër i drejtë midis të drejtave dhe interesave konkurruese. GJEDNJ, duke vlerësuar se nuk kishte një qasje uniforme në legjislacionin e Shteteve Kontraktuese, konstatoi se në rastin konkret nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme e Qipros ishte e qartë se interesit të përgjithshëm dhe të drejtave dhe interesave konkurruese të babait të supozuar dhe familjes së tij i ishte dhënë një peshë më e madhe sesa të drejtës së parashtrueses për të njohur origjinën e saj. Në vijim, GJEDNJ kishte vlerësuar se aplikimi i një afati të ngurtë kohor për inicimin e procedurës së njohjes së atësisë, pavarësisht nga rrethanat e rastit individual dhe në veçanti, njohuria e parashtrueses për faktet në lidhje me të atin e saj biologjik, kishin dëmtuar pikërisht thelbin e së drejtës së parashtrueses për të respektuar jetën e saj private. Rrjedhimisht, GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së.

115. Bazuar në përmbledhjet e rasteve të lartcekura, Gjykata vëren se rrethanat e këtyre rasteve ndërlidhen kryesisht me të drejtën e fëmijëve për të njohur prindërit e tyre biologjikë, përveç rastit *Anayo kundër Gjermanisë*, i cili rast ndërlidhej me të drejtën e babait për të pasur kontakt me fëmijët e tij biologjikë, të cilët jetonin me nënën e tyre dhe bashkëshortin e saj. Në këto raste GJEDNJ kishte aplikuar testet përkatëse në kuptimin nëse obligimet e shteteve përbënin një detyrim pozitiv për shtetet përkatëse për të ndërmarrë masa apo detyrim negativ, përkatësisht nëse refuzimi i kërkesës së parashtruesve të kërkesës përbënte ndërhyrje në të drejtën e tyre për respektim të së drejtës private dhe familjare të garantuar me nenin 8 të KEDNJ-së.

116. Gjykata vë theks në faktin që rasti i parashtrueses së kërkesës dallon nga rastet e lartcekura të GJEDNJ-së dhe të njëjtat vështirë se mund të gjejnë zbatim në rrethanat e rastit konkret. Kjo për arsye se këto të fundit kryesisht ndërlidhen më të drejtat e fëmijëve biologjikë, në cilësi të parashtruesve të kërkesës para gjykatave të shteteve përkatëse dhe para GJEDNJ-së për të njohur origjinën e tyre. Më konkretisht, rasti i parashtrueses së kërkesës ndërlidhet me kërkesën e saj, në cilësinë e nënës biologjike që të obligohen autoritetet publike për ta informuar fëmijën e saj biologjik tashmë të moshës madhore se është i adoptuar, në mënyrë që ajo të ketë mundësinë e njohjes me të në rast se ky do të shprehte interesim.

117. Siç u theksua më lart, pas vlerësimit të aplikueshmërisë së nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata ripërsërit se duhet të përcaktojë nëse

kërkesa dhe pretendimet e parashtrueses së kërkesës, duhet të trajtohen nga perspektiva e detyrimeve negative apo pozitive të shtetit. Përderisa, siç ka theksuar edhe vetë GJEDNJ, dallimi në mes të këtyre dy kategorive detyrimesh nuk është gjithnjë i prerë, në parim kategoria e parë ndërlidhet me detyrimin e shtetit për të mos "ndërhyrë" në të drejtat dhe liritë themelore, përderisa kategoria e dytë, ndërlidhet me detyrimin e shtetit për ndërmarrjen e masave përmes të cilave sigurohet garantimi i të drejtës së parashtruesit përkatës për jetë private. Në kuptim të kësaj të fundit, Gjykata, duke iu referuar edhe kritereve të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me obligimet pozitive që shtetet duhet ti ndërmarrin për gëzimin efektiv të së drejtës për jetë private të parashtruesve, në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së, konsideron se duhet të vlerësohet në kuptim të një ekuilibrit të drejtë që duhet të arrihet midis interesave konkurruese të individit dhe komunitetit në tërësi (shih rastet e GJEDNJ-së, *Evans kundër Mbretësisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 75; *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 40; dhe *Odievre kundër Francës*, të cituar më lart, paragrafi 40).

(i) Nëse rasti ngërthen një ndërhyrje ose detyrim pozitiv

118. Në lidhje me këtë, GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore në veçantin në rastin e lartcekur *I.S. kundër Gjermanisë* kishte konstatuar se *"përderisa qëllimi thelbësor i nenit 8 të KEDNJ-së është që ti mbrojë individët nga ndërhyrjet arbitrare nga ana e autoriteteve publike, kjo thjesht nuk e detyron shtetin që të abstenojë nga një ndërhyrje e tillë; përveç kësaj ndërhyrje negative, aty mund të ketë edhe detyrime pozitive, që janë të qenësishme në respektimin efektiv të jetës private apo familjare [...]"* (paragrafi 70, i Aktgjykimit). Në vijim të kësaj, GJEDNJ në këtë rast konsideroi se ekzistojnë elemente që mund të sugjerojnë që vendimi i gjykatave të Gjermanisë mund të konsiderohet në dritën e detyrimeve pozitive. Edhe në këtë rast, GJEDNJ kishte theksuar se kufijtë në mes të detyrimeve pozitive dhe negative të shtetit nuk lejojnë një përkufizim preciz, por kishte konsideruar se parimet e aplikueshme janë megjithatë të ngjashme (paragrafi 70, i Aktgjykimit). GJEDNJ, në këtë rast, duke iu referuar edhe praktikës së vet gjyqësore kishte theksuar se *"Në përcaktimin e saj, nëse një obligim i tillë ekziston, duhet të merret në konsideratë ekuilibëri drejtë i cili duhet të ndiqet në mes të interesit të përgjithshëm dhe interesit individual"; dhe në kuptim të* të dyjave, shteti gëzon një hapësirë të vlerësimi *(margin of appreciation)"* (shih paragrafin 70, të Aktgjykimit në rastin *I.S. kundër Gjermanisë* dhe referencat e përdorura aty në rastet *Mikulić kundër Kroacisë*, të cituar më lart, paragrafi 58; *Evans kundër Mbretërisë së Bashkuar,* cituar më lart, paragrafi 75, *S.H. dhe të tjerët kundër Austrisë* [DHM], Aktgjykim, i 3 nëntorit 2011, paragrafi 88).

119. Megjithatë, marrë për bazë: (i) kërkesën specifike të parashtrueses së kërkesës; (ii) legjislacionin përkatës në fuqi që ndërlidhet me këtë çështje, në veçanti të të drejtave të familjes adoptuese dhe të adoptuarit; (iii) shqyrtimit të kërkesës së parashtrueses nga ana e autoriteteve shtetërore, në veçanti asaj të Qendrës për Punë Sociale, në cilësinë e autoritetit kompetent i veshur me përgjegjësi dhe detyrime të specifikuara me ligj dhe akte nënligjore përkatëse; (iv) konstatimin e gjykatave të rregullta që organet kompetente nuk kanë bazë ligjore për të njoftuar fëmijën e saj biologjik se është i adoptuar dhe se e drejta për të njohur prindërit biologjikë është e rezervuar vetëm për fëmijën e adoptuar në momentin e arritjes së moshës madhore, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, kërkesa e parashtrueses së kërkesës duhet të shqyrtohet në kuptim të detyrimit negativ, përkatësisht nëse vendimet e gjykatave të rregullta kishin ndërhyrë në respektimin e të drejtës private të parashtrueses së kërkesës, të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së.

120. Thënë këtë, Gjykata gjatë vlerësimit të saj nëse refuzimi i kërkesës së parashtrueses së kërkesës përbën ndërhyrje në të drejtën e saj të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së do zbatojë nenin 55 të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 8 të KEDNJ-së.

121. Përkitazi me zbatimin e nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në rrethanat e rastit konkret, Gjykata, në vijim rikujton se ky nen përcakton se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë: (i) "mund të kufizohen vetëm me ligj"; (ii) ndërhyrja dhe kufizimi i një të drejtë apo lirie duhet të ketë dhe të ndjekë një "qëllim legjitim"; (iii) të drejtat dhe liritë e njeriut mund të kufizohen vetëm "deri në atë masë sa është e domosdoshme" respektivisht nëse kufizimi është proporcional; dhe (iv) kufizimet e bëra me ligj duhet të jenë të tilla që të konsiderohen si të nevojshme në një "shoqëri të hapur dhe demokratike".

122. Ndërsa në paragrafin e katërt të nenit 55 të Kushtetutës theksohet fakti që me rastin e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, krijohet një përgjegjësi kushtetuese për institucionet e pushtetit publik, e sidomos për gjykatat që gjatë interpretimit dhe vendosjes në rastet para tyre, t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës e cila është kufizuar, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël. Përfundimisht, në paragrafin e pestë të nenit 55 të Kushtetutës theksohet se kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë

Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar. Se çfarë është esenca e një të drejte të garantuar varet nga lloji i të drejtës ose lirisë në fjalë (shih rastin e Gjykatës KO54/20, parashtrues *Presidenti i Republikës së Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës*, Aktgjykim, i 31 marsit 2020, paragrafët 194-195).

123. Për qëllime interpretative të këtyre nocioneve dhe koncepteve, Gjykata rikujton se edhe GJEDNJ gjatë shqyrtimit të rasteve para saj për të konstatuar se në një rast konkret a ka pasur kufizim dhe shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me KEDNJ aplikon të njëjtat koncepte, përkatësisht nëse kufizimi apo ndërhyrja: (i) ka qenë "në përputhje me ligjin" ose "e përcaktuar me ligj"; (ii) ka "ndjekur një qëllim legjitim"; dhe (iii) ka "qenë e domosdoshme në një shoqëri demokratike." Në rastin konkret, në lidhje me të drejtën për respektimin e jetës private të garantuar me nenin 8 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton që paragrafi 2 i këtij neni përcakton të njëjtin detyrim përkatësisht "*2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve".*

(ii) Vlerësimi në bazë të nenit 55 të Kushtetutës dhe paragrafit 2 të nenit 8 të KEDNJ-së

124. Rrjedhimisht, bazuar në atë si më lart, Gjykata në kuptim të nenit 55 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 8 të KEDNJ-së do të vlerësojë nëse vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta ishin (i) në përputhshmëri më ligjin; (ii) kanë "ndjekur një qëllim legjitim"; dhe (iii) ka qenë "e domosdoshme në një shoqëri demokratike". Në vlerësimin e këtyre, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, për aq sa është e aplikueshme në rrethanat e rastit konkret. Thënë këtë, Gjykata, në vijim do t'i referohet analizës dhe shqyrtimit të kushteve të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 8 të KEDNJ-së, duke iu referuar edhe rastit të lartcekur të GJEDNJ-së *I.S. kundër Gjermanisë*. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata rikujton se rrethanat faktike të këtij rasti nuk janë identike me atë në rastin e parashtrueses së kërkesës për arsyet si në vijim: në rastin *I.S. kundër Gjermanisë*, parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar qasje në informata dhe takim me fëmijët e saj biologjikë të adoptuar dhe në atë kohë ishin të moshës minore. Përderisa në rastin e parashtrueses së kërkesës, kjo e fundit kërkesën e saj në Qendrën për Punë Sociale, përmes së cilës kishte kërkuar që kjo qendër të njoftojë fëmijën e saj biologjik se është i adoptuar dhe si rezultat i kësaj, ajo shpreh

interesimin e saj për ta njoftuar fëmijën e saj biologjik. Në lidhje me këtë të fundit, kërkesa e parashtrueses së kërkesës i referohet edhe një elementi shtesë, përkatësisht obligimit të Qendrës Familjare për ta njoftuar fëmijën e saj biologjik në lidhje me rrethanat e adoptimit, më specifikisht për faktin se ai është i adoptuar, për të cilin obligim parashtruesja e kërkesës pretendon se buron nga paragrafi 2 i nenit 194 të Ligjit për Familjen. Megjithatë, Gjykata vlerëson se mund t'i referohet parimeve apo konstatimit të GJEDNJ-së përkitazi me vlerësimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 8 të KEDNJ-së, për aq sa ato mund të jenë të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret.

(a) në pajtim me ligjin

125. GJEDNJ në mënyrë të përsëritur kishte theksuar se çdo ndërhyrje e autoritetit publik në të drejtën e individit për respektim të jetës private dhe korrespodencës duhet të jetë në pajtim me ligjin (shih rastin e GJEDNJ-së*, Klaus Muller kundër Gjermanisë,* Aktgjykim, i 19 nëntorit 2020, paragrafët 48-51). Në vijim, GJEDNJ po ashtu kishte nënvizuar që "në pajtim e ligjin" i referohet edhe kualitetit të ligjit, i cili kërkohet të jetë në pajtim me sundimin e ligjit (shih rastin *Halford kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Aktgjykim, i 25 qershorit 1997, paragrafi 49).

126. Gjykata vëren se as neni 194 i Ligjit për Familjen dhe as nenet 17 dhe 18 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së nuk i japin të drejtë parashtrueses së kërkesës që të ketë qasje në informata për fëmijën e saj biologjik. Sipas këtyre dispozitave, e drejta për qasje në informata është e rezervuar vetëm për fëmijën e adoptuar, i cili nëse shpreh dëshirën për të njohur prindërit e tij/saj biologjikë këtë mund ta kërkojë pasi ta ketë arritur moshën madhore. Thënë këtë, Gjykata rikujton që për aq sa është njoftuar përmes shkresave të lëndës, një mundësi të tillë fëmija biologjik i parashtrueses së kërkesës dhe i dhënë për adoptim deri në këtë fazë nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë të përcaktuar me ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata po ashtu rikujton se në momentin e parashtrimi të kërkesës nga parashtruesja e kërkesës në Qendrën për Punës Sociale, fëmija i saj biologjik ishte i moshës madhore.

127. Gjykata më tej vëren se sipas dispozitave ligjore të aplikueshme në fuqi, pushimi i të drejtës ligjore të parashtrueses së kërkesës si prind është pasojë e dhënies së pëlqimit të saj për adoptim. Thënë këtë, përmes dhënies së pëlqimit të saj për adoptim, edhe GJEDNJ kishte vlerësuar se kanë përfunduar edhe të drejtat e saj për të kontaktuar fëmijën e saj. Gjykata rikujton se në bazë të dosjes së lëndës, nuk rezulton që çështja e dhënies së pëlqimit të parashtrueses së kërkesës është kontestuar në

procedura para gjykatave të rregullta, përfshirë edhe në procedurën e zhvilluar gjyqësore, e cila është objekt shqyrtimi i kësaj kërkese (shih në lidhje me këtë vlerësimin e GJEDNJ-së në paragrafët 72 dhe 73, të Aktgjykimit në rastin e lartcekur *I.S. kundër Gjermanisë*).

128. Megjithatë, Gjykata duke iu referuar kërkesës së parashtrueses së kërkesës, përkatësisht elementit të parë të kësaj kërkese, përmes së cilit parashtruesja e kërkesës ka kërkuar nga Qendra për Punë Sociale që ta njoftojë fëmijën e saj biologjik vëren se ajo këtë e mbështet duke interpretuar se ky obligim buron nga paragrafi 2 i nenit 194 të Ligjit për Familjen. Në kuptim të kësaj, Gjykata i referohet paragrafit 2 të nenit 194 të Ligjit për Familjen, i cili përcakton që: *"Në moshën madhore i adoptuari ka të drejtë në qasje në të gjitha informatat lidhur me adoptimin e tij dhe me kërkesë të tij do ti ofrohen informata personale për prindërit e tij biologjik"*. Kjo e drejtë e të adoptuarit është e përcaktuar edhe në paragrafin 2 të nenit 18 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së.

129. Bazuar në dispozitat e lartcekura të Ligjit për Familjen dhe të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së, si dhe në dispozitat e tjera të të njëjtit ligj dhe të udhëzimit të lartcekur, respektivisht, Gjykata vëren se një obligim i tillë për Qendrën për Punë Sociale apo MPMS-në që të njoftohet fëmija biologjik se është i adoptuar nuk është i përcaktuar me asnjë dispozitë të këtyre dy akteve të lartcekura. Në vijim të kësaj, Gjykata i referohet paragrafit 3 të nenit 17 [Pas themelimit të adoptimit] të Udhëzimit të MPSMS-së, i cili përcakton që: " *QPS-ja kompetente për fëmijën, është e obliguar që të ruaj konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijës gjatë tërë procesit të adoptimit dhe pas adoptimit; dhe në asnjë rrethanë nuk duhet të ofroj dokumentacion ose informacion nga dosja e fëmijës përjashtimisht personave zyrtar kompetente ne QPS, DPSF te MPMS-së dhe gjykatë."* Përkitazi me këtë dispozitë, Gjykata vendos theksin në formulimin *"QPS-ja kompetente për fëmijën, është e obliguar që të ruaj konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijës gjatë tërë procesit të adoptimit dhe pas adoptimit"*.

130. Prandaj, bazuar në atë si më lart dhe po ashtu duke marrë në konsideratë faktin që kërkesa e parashtrueses së kërkesës shprehimisht nuk përmbante kërkesën që ajo drejtpërsëdrejti të ketë qasje në të dhënat e procedurës së adoptimit dhe familjes adoptuese, konstaton se: (i) refuzimi i gjykatave për ta aprovuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës; dhe (ii) arsyetimet e dhëna nga gjykata e rregullta përkitazi me refuzimin e kërkesës së saj janë të bazuara në ligj.

(b) qëllimi legjitim

131. Paragrafi 2 i nenit 8 numëron qëllimet legjitime që justifikojnë kufizimin e të drejtave që mbrohen përmes nenit 8 të KEDNJ-së: *"në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve"*. GJEDNJ megjithatë ka vlerësuar që ky vlerësim është për autoritetet vendore që të mbështesin që ndërhyrja ka ndjekur një qëllim legjitim (shih rastin e GJEDNJ-së *Mozer kundër Republikës së Moldavisë dhe Rusisë* [DHM], Aktgjykim, i 23 shkurtit 2016, paragrafi 194).

132. Gjykata, fillimisht duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe në mënyrë specifike rastit të sipërcekur *I.S. kundër Gjermanisë* ka theksuar se *"dispozita ligjore [të Gjermanisë] përkitazi me adoptimin e fëmijëve nuk përcaktojnë të drejtën e prindërve biologjikë për të pasur kontakt me fëmijët e tyre të dhënë për adoptim por kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtës së fëmijës për jetë private dhe familjare*". Në vijim, GJEDNJ kishte nënvizuar se dispozitat relevante ligjore të Gjermanisë kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për tu zhvilluar brenda familjes së tyre adoptuese (shih paragrafin 76, i Aktgjykimit). Sipas GJEDNJ-së, dispozita përkatëse ligjore e Gjermanisë ishte edhe në pajtim me nenin 22 të Konventës së Këshillit të Evropës për Adoptim. Në kontekst të kësaj të fundit, se *"duke ndjekur këtë qëllim, dispozitat ligjore gjermane ishin në pajtim me nenin 20 të Konventës Evropiane për Adoptim t ë vitit 1967, sikurse ishin në pajtim edhe me nenin 22 të Konventës së ndryshuar të vitit 2008",*duke rikujtuar faktin se Gjermania nuk ishte palë nënshkruese dhe ratifikuese e kësaj të fundit. Thënë këtë, GJEDNJ duke iu referuar dispozitave të lartcekura të këtyre dy Konventave, theksoi se qëllimi i tyre, sipas raporteve përgatitore të këtyre Konventave, është që të shmangë vështirësitë të cilat mund të lindin nga njohuria e prindërve biologjikë në lidhje me identitetin e adoptuesit. GJEDNJ po ashtu theksoi se: *"në këtë kontekst vëren se Konventa më aktuale [e vitit 2008] lejon rregulla më pak strikte përkitazi me adoptimin, megjithatë e njëjta nuk favorizon një qasje të tillë*".

133. Ngjashëm edhe në rastin konkret, përkatësisht bazuar në përmbajtjen e dispozitave ligjore përkatëse në fuqi në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenin 194 të Ligjit për Familjen dhe nenet 17 dhe 18 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së, Gjykata po ashtu vëren se qëllimi dhe synimi i ligjvënësit në këtë rast është ruajtja e konfidencilaitetit të të dhënave, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtës së fëmijës dhe adoptuesit të tij për jetë familjare, në veçanti zhvillimin e papenguar të marrëdhënies së tyre familjare. Një e drejtë e tillë, përkatësisht për të pasur njohuri apo qasje në informatë lidhur me prindërit biologjikë, ligjvënësi i jep vetëm fëmijës biologjik, i cili në bazë

të zgjedhjes së tij/saj dhe pas arritjes së moshës madhore mund të kërkojë të dhënat për prindërit e tij biologjikë.

134. Po ashtu edhe në kontekstin krahasimor, përkatësisht të legjislacionit të shteteve të tjera përkitazi me adoptimin, dhe në veçanti rregullave që ndërlidhen me të drejtat e prindërve biologjikë, familjeve adoptuese dhe të adoptuarve, Gjykata vëren se qasja në informata rezervohet vetëm për fëmijën e adoptuar, i cili dëshiron që të zbulojë origjinën apo identitetin e prindërve biologjikë (shih në këtë kontekst, dispozitat relevante të ligjeve përkatëse të Belgjikës, Gjermanisë, Kroacisë, Malit të Zi, Shqipërisë dhe Serbisë të sipërcituara në pjesën e titulluar "*Dispozitat relevante ligjore të vendeve të tjera",* të këtij Aktgjykimi*).*

135. Gjykata, duke iu rikthyer kërkesës së parashtrueses së kërkesës, vëren se interpretimi nga ana e gjykatave të rregullta, përfshirë edhe Gjykatën Supreme ishte në pajtueshmëri me vullnetin e ligjvënësit.

136. Gjykata në këtë rast i referohet arsyetimit të dhënë të Gjykatës Themelore duke iu referuar nenit 194 të Ligjit për Familjen, paragrafit 3 të nenit 17 dhe paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 18 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së, nenit 8 të KEDNJ-së, nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe nenit 22 të Konventës Evropiane për Adoptimin e Fëmijës ku kishte theksuar se *"[...] të dhënat e të adoptuarit duhet të ruhen gjatë tërë dhe pas procesit të adoptimit, dhe QPS [Qendra për Punë Sociale], ka për detyrë ti zbulojë ato vetëm në rast e përpara si me ligj, dhe në rast se aplikues/kërkues është vetë i adoptuari madhor, që do të thotë se të drejtë të qasjes në to, e cila nuk mund ti mohohet nga askush, ka i adoptuari madhor".*

137. Së dyti, Gjykata po ashtu i referohet arsyetimit të dhënë të Gjykatës së Apelit, e cila përmes Aktgjykimit të saj kishte vërtetuar qëndrimin e dhënë nga Gjykata Themelore duke konstatuar si në vijim: [...] *të dhënat për adoptimin dhe rrethanat e tij nuk duhet të zbulohen ose hetohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe fëmijës përveç nëse këtë e kërkojnë arsye të veçanta të interesit publik. Në rastin konkret nuk kemi rrethana të veçanta të interesit publik dhe se një kërkesë e tillë është e pranueshme vetëm nga i adoptuari dhe jo nga prindërit e tij biologjik".* Gjykata e Apelit, në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për interpretimin e gabuar të nenit 194 të Ligjit për Familjen arsyetoi se, sipas kësaj dispozite, të drejtën për të parashtruar kërkesë për njohjen e prindërve biologjikë e ka vetëm i adoptuari i moshës madhore.

138. Dhe së treti, Gjykata i referohet edhe arsyetimit të Gjykatës Supreme, e cila në adresimin e pretendimeve të ngritura nga parashtruesja e

kërkesës në kërkesën e saj për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit kishte konstatuar *" [...] qëndrim i kësaj gjykate është se të dhënat dhe rrethanat e adoptimit nuk duhet të zbulohen ose të hulumtohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe të fëmijës, përveç nëse kjo kërkohet për arsye të veçanta dhe për interesin publik. Në rastin konkret nuk ekzistojnë interese të përfitimit publik dhe një kërkesë e tillë aprovohet vetëm nëse paraqitet nga i adoptuari dhe jo nga prindërit e tij biologjikë".* Në kontekst të këtij arsyetimi të Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se kjo e fundit përgjatë arsyetimit të saj në veçanti vuri theksin: (i) në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 194 të Ligjit për Familjen; (ii) në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 17, dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 18 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së duke arsyetuar se Qendra për Punë Sociale është e obliguar të ruajë konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijës gjatë tërë procesit të adoptimit dhe pas tij.

139. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta, dhe në mënyrë specifike Gjykata Supreme, kanë ndjekur qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të palëve të treta, në veçanti të drejtave të fëmijës së adoptuar dhe familjes së tij adoptuese.

(c) I domosdoshëm në një shoqëri demokratike

140. Gjykata fillimisht thekson se GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore kishte specifikuar se nocioni i "domosdoshëm në një shoqëri demokratike" për qëllimet e nenit 8 të KEDNJ-së *"nënkupton që konkluzioni [përkitazi me këtë kriter] duhet të korrespondojë me një "nevojë të ngutshme shoqërore" (pressing social need) dhe, në veçanti, duhet të mbetet proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur."* Sipas GJEDNJ-së kur përcaktohet nëse një ndërhyrje ishte "e domosdoshme", ajo do të marrë parasysh hapësirën e vlerësimit (*margin of appreciation*) që autoritetet shtetërore kanë në diskrecion, por është detyrim i autoritetit shtetëror që të demonstrojë ekzistencën e një nevoje sociale të ngutshme që qëndron mbrapa ndërhyrjes apo kufizimit të kësaj të drejte (shih rastin e GJENDJ-së, *Piechowicz kundër Polonisë*, Aktgjykim, i 17 prillit 2012, paragrafi 212).

141. Çështja që duhet të adresohet në vijim është nëse vendimet e gjykatave të rregullta përkitazi me refuzimin e parashtrueses së kërkesës ishin të domosdoshme që të ndjekin qëllimin e lartcekur me ligj dhe kanë mundësuar një ekuilibër të drejtë në mes të drejtave të fëmijës së adoptuar, familjes adoptuese dhe të drejtës private të parashtrueses së kërkesës si nënë biologjike (shih në mënyrë të ngjashme paragrafin 79 të Aktgjykimit në rastin *I.S. kundër Gjermanisë*).

142. Gjykata, duke aplikuar këtë kriter në rrethanat e parashtrueses së kërkesës, vlerëson se procedura në gjykatat e rregullta që ndërlidhen me kërkesën e parashtrueses së kërkesës, të iniciuar në Qendrën për Punë Sociale, në tërësinë e tyre ishin të drejta.

143. Gjykata përsërit se të drejtat ligjore të parashtrueses së kërkesës në lidhje me fëmijën e saj biologjik pushuan si rezultat i pëlqimit të dhënë për adoptim dhe këtë të fundit e kishte dhënë në dijeni të plotë të pasojave ligjore dhe faktike.

144. Në vijim, Gjykata vlerëson se vendimet e gjykatave të rregullta për t'i dhënë përparësi konfindencialitetit të fëmijës së saj biologjik, tashmë të moshës madhore dhe familjes adoptuese ishin proporcionale. Për më tepër, Gjykata gjen se gjykatat e rregullta në konstatimin e tyre në mënyrë të drejtë kishin zbatuar ligjin, kur kishin konstatuar se një obligim i tillë për njoftimin e fëmijës që është i adoptuar nuk është i paraparë me legjislacionin në fuqi.

145. Prandaj, Gjykata vlerëson se vendimet e gjykatave të rregullta, përmes së cilave ishte refuzuar kërkesa specifike e parashtrueses së kërkesës ishin të domosdoshme për arsye se ishin: (i) të paraparë me ligj; (ii) kishin ndjekur një qëllim legjitim; dhe (iii) po ashtu kishin ndjekur një ekuilibër të drejtë në mes interesave të fëmijës së adoptuar, tashmë të moshës madhore dhe respektimin e të drejtës së tij private dhe familjare brenda familjes së tij adoptuese. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se konstatimet e gjykatave të rregullta, përfshirë edhe Gjykatën Supreme ishin proporcionale.

146. Bazuar në sqarimin si më sipër, Gjykata konstaton se Aktgjykimi [ARJ-UZVP. nr. 37/2020] i 11 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [AA. nr. 178/2019] e 15 majit 2020, të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [A. nr. 651/16] e 25 janarit 2019, të Gjykatës Themelore nuk është i përfshirë në shkelje të së drejtës së parashtrueses së kërkesës për respektimin e jetës së saj private, të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së.

147. Në kuptim të objektit të çështjes së kërkesës, Gjykata vë në pah dhe sqaron se kërkesa e parashtrueses së kërkesës përkitazi me pretendimin e saj për shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së është trajtuar dhe shqyrtuar në kuptim të kërkesës së saj të parashtruar pranë autoriteteve publike dhe gjykatave të rregullta, dhe se për objekt shqyrtimi të kësaj kërkese nuk përbën shqyrtimi dhe elaborimi i të drejtave të fëmijës së adoptuar për të kërkuar informata në lidhje më

prindërit biologjikë, e të cilat janë përcaktuar përmes ligjit në fuqi, konventave ndërkombëtare dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

148. Pas konstatimeve të lartcekura, Gjykata në vijim gjithashtu do të shqyrtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës përkitazi me shkeljen e të drejtës së saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në kuptim të pretendimit specifik të saj për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Për këtë qëllim, Gjykata do të shtjellojë parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe e GJEDNJ-së përkitazi me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

A. Parimet e përgjithshme

149. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 24 majit 2005; dhe *Tatishvili kundër Rusis*ë, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj,* Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic,* Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverbrand*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

150. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* të cituar më lart, paragrafi 139).

151. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-*së Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

152. Për më tepër, GJEDNJ gjithashtu përdor konceptin e "*mjaftueshmërisë së arsyetimit*" edhe në rastet kur i dëshirueshëm do të mund të ishte një arsyetim më i gjërë dhe më i detajuar (shih rastin *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe i 28 nëntorit 2017, paragrafi 227). Ndonëse rrethanat e rastit konkret nuk janë të njëjta me ato të rastit të referuar të GJEDNJ-së, koncepti i "*mjaftueshmërisë së arsyetimit*" përmes këtij rasti të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-në nënkupton që arsyetimi i vendimeve përkatëse të gjykatave të rregullta, në rrethana të caktuara, edhe pse jo i dëshirueshëm, mund të jetë i mjaftueshëm. Në këtë aspekt, në Aktgjykimin e lartcekur të GJEDNJ-së, kjo e fundit kishte theksuar me sa vijon: *"*Përderisa *një arsyetim më i detajuar do të ishte i dëshirueshëm, Gjykata* [GJEDNJ] *është e kënaqur që ky* [arsyetim] *ishte i mjaftueshëm në këto rrethana"* (shih, gjithashtu rastin nr. KI48/18, me parashtrues, *Arban Abrashi dhe*

Lidhja Demokratike e Kosovës, Aktgjykim i 4 shkurtit 2019, paragrafi 186).

B. Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

153. Gjykata fillimisht në mënyrë të përmbledhur rikujton se parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të parashtruar në Gjykatën Supreme kishte pretenduar si në vijim: (i) përkitazi me pretendimin e saj për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, parashtruesja e kërkesës kishte theksuar se *"është detyrë e organit të kujdestarisë që përveç këshillave, të njoftojë dhe udhëzojë prindërit adoptues si dhe fëmijët e kësaj moshe se, posa fëmija të arrije moshën 18 vjeçare, ai e fiton të drejtën ligjore për të parë të dhënat e adoptimit, përfshirë këtu edhe të dhënat personale për prindërit biologjik"*. Sipas saj: *"[...] pastaj është vetëm e drejtë ekskluzive e të birësuarit se, a dëshiron t'i njohë dhe të kontaktojë me prindërit biologjik, të tij";* (ii) po ashtu kishte specifikuar se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ishte i përfshirë me mungesë të arsyetimit të vendimit gjyqësor; dhe (iii) se ajo nuk ka kërkuar që ajo personalisht të ketë qasje ne dokumentacionin e adoptimit të fëmijës së saj biologjik, por ka kërkuar që fëmija i saj biologjik të njoftohet për faktin e birësimit të tij, në mënyre që ai të ketë të drejtë të vendos nëse dëshiron ta njoftojë nënën e tij biologjike.

154. Përderisa në kërkesën e saj në Gjykatë përkitazi me pretendimin e saj për mos arsyetim të vendimit gjyqësor, parashtruesja e kërkesës specifikon se kërkesa e saj e ngritur para instancave gjyqësore është keqkuptuar për arsye se ajo nuk ka kërkuar që ajo personalisht të ketë qasje në dokumentacionin e adoptimit të fëmijës së saj biologjik, por ka kërkuar që fëmija i saj biologjik të njoftohet për faktin e birësimit të tij, në mënyre që ai të ketë të drejtë të vendos *"nëse dëshiron apo jo ta njoh nënën e tij biologjike"*. Në vijim, parashtruesja e kërkesës specifikon se kjo kërkesë themelore e paraqitur në padinë e saj para Gjykatës Themelore nuk është adresuar nga gjykatat e rregullta. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesja e kërkesës po ashtu thekson se gjykatat e rregullta asnjëherë nuk kanë dhënë arsye se pse nuk janë të zbatueshme dispozitat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

155. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata rikujton kërkesën e parashtrueses së kërkesës të parashtruar në Qendrën për Punë Sociale, përmes së cilës kishte kërkuar që fëmija i saj biologjik, i moshës madhore dhe të cilin e kishte dhënë për birësim në vitin 1989 të njoftohet: (i) në lidhje me ekzistimin e nënës së tij biologjike dhe (ii) interesimin e saj për ta njoftuar atë. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesja e kërkesës këtë kërkesë e kishe bazuar në nenin 194,

paragrafin 2 të Ligjit për Familjen të Kosovës, nenin 8 të KEDNJ-së dhe nenin 22 të Konventës Evropiane për Adoptimin e Fëmijëve.

156. Në përgjigjen ndaj kërkesës së parashtrueses së kërkesës, Komisioni i Ankesave i MPMS-së duke iu referuar dispozitave të lartcekura të Ligjit për Familjen, respektivisht nenit 194 dhe neneve 17 dhe 18 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së kishte arsyetuar se "*nuk ka asnjë mbështetje ligjore dhe obligim ligjor që ta informoj fëmijën e adoptuar për familjen biologjike përderisa fëmiu biologjik nuk paraqet kërkesë me shkrim për njohjen e prindërve biologjik. E drejta ekskluzive për kërkim të prindit/ërve biologjik është e fëmijës*".

157. Në vijim, Gjykata rikujton se si rezultat i kërkesëpadisë së parashtrueses së kërkesës në Gjykatën Themelore, kjo e fundit e kishte mbështetur konstatimin e lartcekur të Komisionit të MPMS-së duke interpretuar nenin 194 të Ligjit për Familjen dhe nenet 17 dhe 18 të Udhëzimit Administrativ të MPMS-së. Në vijim të kësaj, Gjykata e Apelit po ashtu kishe konstatuar se "*të dhënat për adoptimin dhe rrethanat e tij nuk duhet të zbulohen ose hetohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe fëmijës përveç nëse këtë e kërkojnë arsye të veçanta të interesit publik. Në këtë kontekst, Gjykata e Apelit kishte konstatuar se në rastin konkret nuk ekzistojnë rrethana të veçanta të interesit publik dhe se një kërkesë e tillë është e pranueshme vetëm nëse është parashtruar nga i adoptuari dhe jo nga prindërit e tij biologjik*".

158. Përderisa Gjykata Supreme në adresimin e pretendimeve të ngritura nga parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit kishte theksuar se "*Me nenin 194 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Kosovës për familjen përcaktohet se, faktet të cilat do të mundë të zbulonin ekzistimin dhe rrethanat e adoptimit të fëmijës nuk guxojnë të zbulohen e as të hetohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe të fëmijës, përveç nëse kjo kërkohet për arsye të veçanta dhe për interesin publik. Me arritjen e moshës madhore, i adoptuari fiton të drejtën në qasje në të gjitha informatat lidhur me adoptimin e tij dhe me kërkesë të tij do t'i ofrohen informata personale për prindërit e tij biologjik. Me nenin 17, paragrafi 1 dhe 2 i Udhëzimit Administrative Nr. 09-2014 për rregullimin e procedurave të adoptimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore përcaktohet që QPS kompetente për fëmijën, është e obliguar që të ruajnë konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijës gjatë tërë procesit të adoptimit, dhe asnjë rrethanë nuk duhet të ofrojë dokumentacionin nga dosja e fëmijës, përjashtimisht personave zyrtar kompetent nga QPS, DPSF (MPMS) dhe Gjykatë. Neni 18 paragrafi 1 Udhëzimit të cekur Administrativë, përcakton se për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë e informacioneve të mbledhura*

gjatë procesit të adoptimit, janë përgjegjës Gjykata Themelore ku është bërë adoptimi dhe Organi i Kujdestarisë kompetent për mbrojtjen e fëmijës, ndërsa me paragrafin 2 parashihet që i adoptuari më moshën madhore ka të drejtë në të gjitha informatat lidhur me adoptimin e tij dhe me kërkesë të tij do t'i ofrohen informata personale për prindërit e tij biologjikë".

159. Gjykata, duke iu referuar edhe pretendimit të parashtrueses së kërkesës në kërkesën e parashtruar në Gjykatën Supreme, dhe në atë në Gjykatë vendos theksin në arsyetimin e Gjykatës Supreme si në vijim: *"Duke pasur parasysh nenet e sipërcekura të Ligjit dhe të Udhëzimit dhe sipas mendimit të kësaj, gjykata, e paditura [parashtruesja e kërkesës], gjegjësisht nëna biologjike e fëmiut të adoptuar nuk ka bazë ligjore që të informoj fëmiun e adoptuar për nënën e tij biologjike derisa fëmiu i adoptuar nuk të paraqesë kërkesë të shkruar për të njohur prindërit e tij biologjikë, meqë kjo e drejtë i takon vetëm fëmiut. Në fakt, qëndrimi i kësaj gjykata është se të dhënat dhe rrethanat e adoptimit nuk duhet të zbulohen ose të hulumtohen pa pëlqimin e adoptuesit dhe të fëmijës, përveç nëse kjo kërkohet për arsye të veçanta dhe për interesin publik. Në rastin konkret nuk ekzistojnë interese të përfitimit publik dhe në kërkesë e tillë aprovohet vetëm nëse paraqitet nga i adoptuari dhe jo nga prindërit e tij biologjikë".*

160. Gjykata duke rikujtuar: (i) pretendimin specifik të parashtrueses së kërkesës se gjykatat e rregullta nuk kanë trajtuar kërkesën e saj specifike të parashtruar në Qendrën për Punë Sociale dhe kërkesëpadinë e saj në Gjykatën Themelore, gjegjësisht se ajo përmes këtyre të fundit shprehimisht kishte kërkuar që të kërkohet nga Qendra për Punë Sociale që të njoftohet fëmija i saj biologjik i moshës madhore në lidhje me birësimin e tij; dhe (ii) arsyetimin e sipërcekur të gjykatave të rregullta, konsideron se këto të fundit i janë përgjigjur dhe kanë adresuar kërkesën e saj duke vënë theksin në faktin se me asnjë bazë ligjore nuk është e përcaktuar që Qendra për Punë Sociale apo MPMS janë të obliguara që ta njoftojnë fëmijën e saj biologjik për faktin e birësimit të tij.

161. Në vijim, dhe bazuar në arsyetimet e lartcekura, të ofruara nga gjykatat e rregullta, në veçanti të asaj të Gjykatës Supreme, Gjykata rikujton se në rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë, si në rastin e parashtrueses së kërkesës Gjykata Supreme, e cila vërteton vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta (shih, në mënyrë të ngjashme, rastet e Gjykatës KI194/18, parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shkurtit 2020, paragrafi 106; dhe KI122/19,

parashtrues *F.M.,* Aktvendim për papranueshmëri, i 9 korrikut 2020, paragrafi 100). Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit e as atë të Gjykatës Themelore përmes të cilave është refuzuar kërkesa e parashtrueses së kërkesës të paraqitur në Qendrën për Punës Sociale por vetëm ka vërtetuar konstatimin dhe ligjshmërinë e tij. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme kishte vërtetuar se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ishte i qartë dhe i kuptueshëm dhe se i njëjti përmban arsyetim të mjaftueshëm në lidhje me faktet vendimtare.

162. Nga sa u tha më lart, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, parashtrueses së kërkesës i janë dhënë mundësitë procedurale për të adresuar pretendimet e saj dhe se në substancë, ajo ka marrë përgjigje ndaj pretendimeve thelbësore të saj të parashtruara në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme. Prandaj, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar përmbush kriteret dhe standardin e përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të vet Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së për një vendim të arsyetuar gjyqësor, ashtu siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

163. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër, Gjykata konstaton që Aktgjykimi [ARJ-UZVP. nr. 37/2020] i 11 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme është në pajtueshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përfundime

164. Gjykata në vlerësimin e përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë, përkitazi me pretendimin e parashtrueses së kërkesës përkitazi me nenin 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës konstatoi se kjo dispozitë nuk gjen zbatim në rastin e saj, dhe si i tillë ky pretendim është i papranueshëm. Përderisa përkitazi me pretendimet e parashtrueses së kërkesës se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata konstatoi se kërkesa ka përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë të përcaktuar me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës, dhe rrjedhimisht vazhdoi me shqyrtimin e kërkesës në merita.

165. Pas vlerësimit të meritave të kërkesës së parashtrueses së kërkesës, Gjykata konstatoi se: (i) Aktgjykimi [ARJ.UZVP. nr. 37/2020] i 11 qershorit 2020 i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [AA. nr. 178/2019] e 15 majit 2020, të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [A. nr. 651/16] e 25 janarit 2019, të Gjykatës Themelore është në

pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNJ-së; dhe (ii) Aktgjykimi [ARJ.UZVP. nr. 37/2020] i 11 qershorit 2020 i Gjykatës Supreme është në pajtueshmëri me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

166. Së pari, për të arritur në konstatimin e lartcekur, Gjykata fillimisht ka sqaruar se rrethanat e rastit konkret, përkatësisht refuzimin e autoriteteve publike të kërkesës së parashtrueses së kërkesës për ta njoftuar fëmijën e saj biologjik të moshës madhore për ekzistimin e saj dhe interesimin e saj për ta njoftuar atë ngërthejnë çështje që ndërlidhen me të drejtën në jetë private, në kuptim të nocionit të së drejtës private të parashtrueses së kërkesës siç është garantuar me paragrafin 1 të nenit 8 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se neni 36, paragrafi 1 i Kushtetutës dhe neni 8, paragrafi 1 i KEDNJ-së janë të aplikueshëm në rastin e parashtrueses së kërkesës. Në këtë kontekst dhe përgjatë shqyrtimit të këtij rasti, Gjykata ka shtjelluar parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e e GJEDNJ-së përkitazi me paragrafin 2 të nenit 8 të KEDNJ-së për të konstatuar nëse vendimet e autoriteteve publike për refuzimin e kërkesës së parashtrueses së kërkesës përbëjnë ndërhyrje në të drejtën e saj të garantuar me nenin 36, paragrafin 1 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 8 të KEDNJ-së, dhe më pas ka aplikuar të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Në këtë aspekt, dhe në kuptim të objektit të çështjes së kërkesës, Gjykata po ashtu sqaroi, se kërkesa e parashtrueses së kërkesës është trajtuar dhe shqyrtuar në kuptim të kërkesës së saj të parashtruar pranë autoriteteve publike dhe gjykatave të rregullta, dhe se për objekt shqyrtimi të kësaj kërkese nuk përbëjnë shqyrtimi dhe elaborimi i të drejtavë të fëmijës së adoptuar për të kërkuar informata në lidhje më prindërit biologjikë, të cilat janë përcaktuar përmes ligjit në fuqi, konventave ndërkombëtare dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

167. Së dyti, përkitazi me pretendimin për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata, duke aplikuar parimet e përgjithshme të vendosura përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në rrethanat e rastit konkret ka konstatuar se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmbush kriteret dhe standardin për një vendim të arsyetuar gjyqësor, ashtu siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

168. Rrjedhimisht, dhe përfundimisht Gjykata gjeti se Aktgjykimi [ARJ.UZVP. nr. 37/2020] i 11 qershorit 2020 i Gjykatës Supreme është në pajtueshmëri me të drejtat dhe liritë themelore të parashtrueses së kërkesës të garantuara përmes: (i) paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenin 8 të KEDNJ-së; dhe (ii) nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 tetor 2021, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi [ARJ.UZVP. nr.37/2020] i 11 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme është në pajtueshmëri me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi [ARJ.UZVP. nr.37/2020] i 11 qershorit 2020, i Gjykatës Supreme është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Radomir Laban	Gresa Caka-Nimani

KI117/21, Parashtrues: Shefqet Nikqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 360/2020, të 2 prillit 2021

KI117/21, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021, publikuar më 9 nëntor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta në pronë, barazia para ligjit, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, kërkesë qartazi e pabazuar, pretendime të shkallës së katërt, pretendime të pambështetura dhe të paarsyetuara*

Nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Komunale në Pejë kishte parashtruar kërkesëpadi përmes të cilës kishte specifikuar se pas angazhimit të gjeodetit në vitin 2007 ishte konstatuar se mexha apo vija përkufizuese në mes të paluajtshmërisë, gjegjësisht ngastrave [320/1 dhe 321/1] të regjistruara në emër të tij dhe paluajtshmërisë së paditurve [J.N dhe D.N], gjegjësisht ngastrës [320/2] nuk është aty ku është e evidentuar në regjistrat kadastralë por është disa metra në thellësi të paluajtshmërisë së paditurve nga ana lindore e paluajtshmërisë së parashtruesit të kërkesës. Në kërkesëpadinë e precizuar të parashtruesit të kërkesës, të parashtruar në Gjykatën Themelore ishte specifikuar se kjo paluajtshmëri kontestuese përfshinte sipërfaqen prej 1670 m2. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata Themelore kishte kërkuar që të (i) aprovohet kërkesëpadia e tij; (ii) të konstatojë se të paditurit J.N dhe D.N kanë uzurpuar paluajtshmërinë e lartcekur të regjistruar në certifikatën e pronësisë në emër të parashtruesit të kërkesës dhe (iii) ti detyrojë paditurit që t'ia kthejnë këtë pjesë të paluajtshmërisë. Më 24 maj 2013, J.N dhe D.N, në cilësinë e të paditurve- kundërpaditësve kishin parashtruar kundërpadi në Gjykatën Themelore përmes të cilës kishin kërkuar që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës dhe të vërtetohet se J.N është pronar në bazë të mbajtjes-parashkrimit fitues të paluajtshmërisë kontestuese. Më 17 qershor 2015, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit C.nr. 561/12 ndër tjerash kishte (i) refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) kishte aprovuar si pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e të paditurit-kundërpaditësit J.N dhe kishte vërtetuar se ky i fundit është pronar në bazë të mbajtjes-parashkrimit fitues të paluajtshmërisë në sipërfaqe prej 1670 m2 në mes të ngastrës 320/1 dhe 320/2 ashtu siç është përcaktuar me paragrafin 4 të nenit 28 të LMTHPJ-së. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, dhe kjo e fundit përmes Aktgjykimit, të 29 janarit 2020 kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pathemeltë duke vërtetuar në tërësi konstatimin dhe qëndrimin e Gjykatës Themelore. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit kishte parashtruar

revizion në Gjykatën Supreme. Më 2 prill 2021, Gjykata Supreme revizionin e parashtruesit të kërkesës e kishte refuzuar si të pathemeltë.

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Kushtetuese pretendoi shkelje (i) të së drejtës së tij për barazi para ligjit, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës; (ii) të drejtës së tij në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës; dhe (iii) të mbrojtjes gjyqësore të drejtave të tij, të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkitazi me (i) pretendimin për shkelje të së drejtës së tij në pronë, konstatoi se ky pretendim është i papranueshëm, si qartazi i pabazuar në baza kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës së Gjykatës; dhe (ii) pretendimet për shkelje të nenit 24 dhe nenit 54 të Kushtetutës, Gjykata konstatoi se këto pretendime janë të pambështetura apo paarsyetuara, dhe rrjedhimisht të papranueshme ashtu siç është përcaktuar me nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe rregullin 39 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së Punës së Gjykatës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI117/21

Parashtrues

Shefqet Nikqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr.360/2020,
të 2 prillit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Shefqet Nikqi, me vendbanim në Pejë, i përfaqësuar me autorizim nga Agim Shala, avokat në Pejë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev. Nr. 360/2020] të 2 prillit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac. Nr. 2837/15] të 29 janarit 2020 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr. 561/12] të 17 qershorit 2015 të Gjykatës Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 19 prill 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 Barazia para Ligjit]; 46 [Mbrojtja e Pronës] paragrafi 1; dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 28 qershor 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.

7. Më 8 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

8. Më 22 korrik 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin ligjor për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të dorëzojë autorizimin për përfaqësim të parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

9. Më 5 gusht 2021, përfaqësuesi i ligjor i parashtruesit të kërkesës dorëzoi autorizimin për përfaqësim të kërkuar nga Gjykata.

10. Më 13 gusht 2021, Gjykata i dorëzoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme. Po të njëjtën dite, Gjykata i dërgoi Gjykatës Themelore në Prishtinë kërkesën që të dorëzojë fletëkthesën e cila dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Supreme.

11. Më 24 gusht 2021, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën, e cila dëshmon se parashtruesi i kërkesës Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 19 prill 2021.

12. Më 21 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 12 korrik 2012, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Komunale në Pejë kishte parashtruar kërkesëpadi për kthimin e pronës së uzurpuar nga J.N dhe D.N. Në kërkesëpadinë e tij, parashtruesi i kërkesës kishte specifikuar se pas angazhimit të gjeodetit në vitin 2007 ishte konstatuar se mexha apo vija përkufizuese në mes të paluajtshmërisë, gjegjësisht ngastrave [320/1 dhe 321/1] të regjistruara në emër të parashtruesit të kërkesës dhe paluajtshmërisë së paditurve nuk është aty ku është e evidentuar në regjistrat kadastralë por është disa metra në thellësi të paluajtshmërisë së paditurve nga ana lindore e paluajtshmërisë së parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Komunale në Pejë që të konstatoj se të paditurit kanë uzurpuar një pjesë të ngastrave kadastrale nr. 320/1 dhe 321/1 të regjistruara dhe evidentuara në certifikatën e pronësisë në emër të parashtruesit të kërkesës.

14. Më 24 maj 2013, J.N dhe D.N parashtruan kundërpadi në Gjykatën Themelore në Pejë përmes të cilës kërkuan që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës dhe të vërtetohet se J.N është pronar në bazë të mbajtjes-parashkrimit fitues. Sipas J.N dhe D.N vija përkufizuese në mes të paluajtshmërive të tyre dhe parashtruesit të kërkesës është përcaktuar me pëlqimin e paraardhësve të tyre të largët. Sipas tyre evidentimi në regjistrat kadastral nuk mund ta ndryshojë gjendjen faktike, e cila sipas tyre ishte caktuar shumë vite më parë.

15. Më 11 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti precizimin e kërkesëpadisë së tij në Gjykatën Themelore në Pejë, përmes të cilës specifikoi se paluajtshmëria e kontestuar, për të cilën kishte parashtruar kërkesëpadi përfshinte sipërfaqe prej 1670 m2.

16. Më 17 qershor 2015, Gjykata Themelore në Pejë, përmes Aktgjykimit C.nr. 561/12 (i) refuzoi në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ; (ii) aprovoi si pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e të paditurit i J.N dhe vërtetoi se J.N është pronar në bazë të mbajtjes parashkrimit fitues i paluajtshmërisë në sipërfaqe

prej 1670 m2 në mes të ngastrës 320/1 dhe 320/2; (iii) refuzoi si pjesërisht të pabazuar kërkesëpadinë e të padituri J.N. përmes të cilës kishte kërkuar që është pronar në bazë të parashkrimit fitues i pjesës së ngastrës 320/2 në sipërfaqe prej 200m2; (iv) detyroi parashtruesin e kërkesës që J.N të i njohë drejtën e pronës, sipas pikës II të dispozitivit dhe të njëjtit ti lejojë regjistrimin e pronës në librat kadastralë; dhe (iv) detyroi parashtruesin e kërkesës që J.N dhe D.N të iu paguajë shpenzimet procedurale.

17. Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj theksoi se me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike me propozim të palëve dhe sipas detyrës zyrtare kishte bërë dëgjimin e dëshmitarëve, kishte caktuar ekspertin gjeodet dhe po ashtu në praninë e ekspertit gjeodetit, palëve ndërgjygjëse dhe të autorizuarve të tyre kishte realizuar edhe daljen daljes në vend. Gjykata Themelore pas vlerësimit të provave kishte konstatuar se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është e pabazuar, dhe rrjedhimisht kishte konkluduar se J.N është pronar në bazë të mbajtjes parashkrimit fitues i paluajtshmërisë në sipërfaqe prej 1670 m2 në mes të ngastrës 320/1 dhe 320/2. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata Themelore iu referua nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike të RSFJ-së, të vitit 1980 (në tekstin e mëtejmë: LMTHPJ) duke konstatuar se J.N të drejtën e pronësisë e ka fituar në bazë të mbajtjes në mirëbesim dhe parashkrimit fitues me kalimin e kohës prej njëzet (20) vitesh. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore duke iu referuar edhe paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 37 të LMTHPJ konstatoi se parashtruesi i kërkesës kishte humbur të drejtën për kthimin e palujetshmërisë pasi që kanë kaluar më shumë se njëzet (20) vite që nga koha kur J.N ka filluar të mbajë paluajtshmërinë kontestuese.

18. Më 10 korrik 2015, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave kontestimore; konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Në kontekst të pretendimit të tij për zbatim të gabuar të drejtës materiale, parashtruesi i kërkesës theksoi se pjesa e paluajtshmërisë së tij është uzurpuar dhe se të padituri këtë pjesë të paluajtshmërisë e mbajnë në keqbesim.

19. Më 29 janar 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr. 2837/15] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.561/12] të 17 qershorit 2015, të Gjykatës Themelore.

20. Gjykata e Apelit fillimisht konstatoi se Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Themelore nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, se Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe po ashtu kjo e fundit në mënyrë të drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale.

21. Gjykata e Apelit vërtetoi se *"Në rastin konkret me provat e administruara është provuar dhe kontinuitetit i posedimit dhe kalimit të afatit të nevojshëm për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, pasi paraardhësi i tyre por edhe [J.N dhe D.N] e kanë mbajtur në posedim te papenguar në raport me [parashtruesin e kërkesës] që nga viti 1973, fakt që nuk është kontestuar as nga [parashtruesi i kërkesës], deri në ushtrimin e padisë së kësaj çështjeje, të njëjtit nuk janë shqetësuar as nga paraardhësit e [parashtruesit të kërkesës], andaj përfundimi i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë [J.N dhe D.N] është në pajtim e të plotë me dispozitat materialo-juridike, në këtë rast të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, neni 28, paragrafi 4, dhe se kushtet që rrjedhin nga përmbajtja e dispozitës së cituar për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues në këtë çështje kontestuese, janë plotësuar në mënyrë kumulative, prandaj gjykata ankimore e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm, vendimin e gjykatës së shkallës së parë."*

22. Më 2 prill 2020, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit parashtroi revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës, ndër tjerash theksoi se (i) Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kanë aplikuar dispozitat e ligjit, gjegjësisht LMTHJP, i cili sipas tij nuk është i aplikueshëm në Republikën e Kosovës që nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 03/L-159 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore në vitin 2009; dhe po ashtu thekson se (ii) *"në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kurrfarë fitimit të pronësisë së parashkrimit fitues në mirëbesim, sepse në rastin konkret nuk ekziston elementi i mirëbesimit. Po ashtu, Gjykata ka qenë dashur që në rastin konkret mund të vij deri te acarimi raporteve dhe marrëdhënieve familjare në mes të ndërgjyqësve dhe atë për shkak të situatës dhe arsyes në çfarë baze e ka fituar të drejtën e pronësisë paraardhësi i [parashtruesit të kërkesës], pra këto dy ngastra, ngastrat nr. 320/1 dhe 321 nga fleta posedues nr. 78 [...] i janë dhënë paraardhësit të parashtruesit të kërkesës në emër të pajtimit të ngatërresës (gjakut)."*

23. Më 2 prill 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. Nr. 360/2020] e refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesit të kërkesës.

24. Gjykata Supreme fillimisht konstatoi se Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale.

25. Gjykata Supreme, po ashtu vërtetoi se J.N ka qenë në posedim me mirëbesim dhe të papenguar nga të tjerët në paluajtshmërinë kontestuese për më shumë se njëzet (20) vite dhe rrjedhimisht në bazë të parashkrimit fitues-mbajtjes sipas paragrafit 4 të nenit 28 të LMTHPJ ka fituar të drejtën e pronësisë mbi këtë paluajtshmëri.

26. Në vijim, Gjykata Supreme konstatoi se fakti që paluajtshmëria kontestuese është e evidentuar në emër të parashtruesit të kërkesës, ky nuk paraqet bazë juridike e as mënyrë të fitimit të pronësisë (*iustus titullus-modus aquirendi*).

27. Në fund, Gjykata Supreme arsyetoi se në rastin konkret ishin aplikuar dispozitat e LMTHPJ për arsye se raporti civilo-juridike në mes palëve ndërgjygjëse është krijuar para hyrjes në fuqi të Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore.

28. Më 26 maj 2021, parashtruesi i kërkesës në Prokurorinë e Shtetit parashtroi propozimin për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore; Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

29. Më 7 qershor 2021, Prokurori i Shtetit përmes Njoftimit [KMLC. Nr. 49/2021] njoftoi parashtruesin e kërkesës se në bazë të paragrafit 3 të nenit 245 të LPK-së propozimi i tij për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë është i palejuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 24 Barazia para Ligjit]; 46 [Mbrojtja e Pronës] paragrafi 1; dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

31. Përkitazi me nenin 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës vetëm thekson se *"Me këto aktgjykime është shkel dispozita e nenit 24 te*

Kushtetutës te R. se Kosovës, për shkak se mendoj se barazia e palëve nuk ka ekzistuar ne rastin konkret."

32. Së dyti, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 46 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Po ashtu është bere shkelje e dispozitës se nenit 46 par. 1te Kushtetutës se R. se Kosovës, sa i përket mbrojtjes se drejtës se pronësisë, me refuzuar e drejta en pronës ku unë jam pronar legjitim dhe i ligjshëm dhe prona e regjistruar ne emër timin."*

33. Së treti, në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës vetëm cekë se *"Është bere [shkelje] e dispozitës se nenit 54 te Kushtetutës se R. se Kosovës, lidhur me mbrojtjen gjyqësore e te drejtave, ktu me janë shkelur te drejtat njerëzore lidhur me pronën."*

34. Parashtruesi i kërkesë në kontekst të pretendimeve të lartcekura të tij po ashtu specifikon se në rastin e tij është shkelur neni 18 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, si dhe paragrafit 1 të nenit 20 dhe paragrafi 1 i nenit 33 të LMTHPJ . Po ashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij janë shkelur dispozitat e procedurës kontestimore, gjegjësisht paragrafi 2 i nenit 182 të LPK-së.

35. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të konstatojë:

"-A ka vendosur drejte Gjykata Themelore ne Peje me aktgjykimin C.nr.561/12 kur e ka refuzuar ne tërësi padinë time, kur unë ne pronën e uzurpuar kur unë jam pronar legjitim dhe i ligjshëm, pronën e kam patur te regjistruar ne emër timin si trashëgimtar legjitim dhe kjo prone është te pareve te mi si dëmshpërblim për pajtim te gjakut-vrasjes. Si mund ti njifet e drejta e pronësisë personit i cili është uzurpues dhe posedues me keqbesim te pasurisë lëndore ne këtë kontest juridiko-civil, kur me Ligjin per Pronen dhe te Drejtat tjera Sendore ne mënyrë taksative theksohet se uzurpuesi-poseduesi me keqbesim nuk mund te behet pronar i patundshmërisë qe e ka ne posedim, dhe kjo cështje ka qene e regulluar si me ligjin e mëparshëm mbi LMTHJP dhe me ligjin e tanishëm LPDTS.

- A ka vendosur drejte Gjykata Themelore ne Peje, kur me aktgjykimin e saj C.nr.561/12, ka vendosur vetëm për te paditurin-kunderpaditesin e pare [J.N.], duke anashkaluar te paditurin-kunderpaditesine e dyte [D.M], dhe duke mos e arsyetuar fare pse nuk është vendosur lidhur me te njëjtin dhe si është fati i pronës se uzurpuar, a ka mbetur ne pronësi te pronarit legjitim dhe te ligjeshem-paditesit, apo te uzurpuesit.

[...]

-Gjykata e shkalles se dyte (Gjykata e Apelit te Kosoves) aka vendosur drejte sipas ligjit, kur e refuzon ankesen time dhe e vërteton ne tërësi aktgjykimin e gjykatës se shkalles se pare dhe Gjykata Supreme e Kosoves, aka vendosur sipas ligjit lidhur me revizionin e ushtruar nga paditësi, si dhe Zyra e Prokurorit te Shetit a ka vendosur drejte lidhur me Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë.

- A ka këtu tejkalim te kompetencave nga ana e gjykatës.
-Me këto akte gjyqësore a mos po behet nxitja ne përtëritjen e vellavrasjeve. (Kjo e ceku si rast i ndieshem ne rastin konkret, e jo kërcenim).”

Dispozita relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës
Neni 24
[Barazia para Ligjit]

Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 46
[Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
[...]

Neni 54
[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

LIGJI MBI MARRËDHËNIET JURIDIKE PRONËSORE [i shpallur më 30 janar 1980]

Neni 28

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fituese me kalimin e kohës prej tre vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.

Mbajtësi me mirëbësim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.

Trashëgimtari bëhet mbajtës me mirëbesim nga momenti i hapjes së trashëgimisë edhe në rastin kur trashëgimlënësi ka qenë mbajtës me këqbesim, e trashëgimtari këtë nuk e ko ditur as që ka mundur ta dinte kurse koha për parashkrimin fitues fillon të ece nga momenti i hapjes së trashëgimisë.

Neni 30

Koha e nevojshme për parashkrimin fitues fillon të ecë nga ajo ditë kur mbajtësi ka marrë në posedim sendin dhe mbaron me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme për parashkrimin fitues.

Në kohën e nevojshme për parashkrimin-fitues llogaritet edhe koha për të cilën paraardhësit e mbajtësit të tanishëm kanë mbajtur sendin si mbajtës me mirëbesim dhe të ligjshëm, respektivisht si mbajtës me mirëbesim.

Sa i përket ndërprerjes, respektivisht, ngecjes së parashkrimit fitues aplikohen me analogji dispozitat mbi ndërprerjen, respektivisht ngecjen e parashkrimit të kërkesës.

Neni 33

Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.

LIGJI NR. 03/L-154 PËR PRONËSINË DHE TË DREJTAT TJERA SENDORE

PJESA III
PRONËSIA KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 18
Pronësia

1. Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti.

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

36. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara*

me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

38. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

39. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është: palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin Rev. Nr. 360/2020 të 2 prillit 2021 të Gjykatës Supreme; ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe, e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.

40. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Në këtë aspekt, Gjykata do t'u referohet rregullave relevante të Rregullores së punës, si në vijim:

Rregulli 39
Kriteret e pranueshmërisë

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(...)

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

41. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *"të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*". Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkese të vlerësuar si "*qartazi të pabazuar*", dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si "*qartazi të pabazuara*" të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20 me parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; dhe KI21/21, me parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021).

42. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të

nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

43. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës të parashtruar në Gjykatën Komunale në Pejë përmes të cilës kishte specifikuar se pas angazhimit të gjeodetit në vitin 2007 ishte konstatuar se mexha apo vija përkufizuese në mes të paluajtshmërisë, gjegjësisht ngastrave [320/1 dhe 321/1] të regjistruara në emër të tij dhe paluajtshmërisë së paditurve [J.N dhe D.N], gjegjësisht ngastrës [320/2] nuk është aty ku është e evidentuar në regjistrat kadastralë por është disa metra në thellësi të paluajtshmërisë së paditurve nga ana lindore e paluajtshmërisë së parashtruesit të kërkesës. Në kërkesëpadinë e precizuar të parashtruesit të kërkesës, të parashtruar në Gjykatën Themelore ishte specifikuar se kjo paluajtshmëri kontestuese përfshinte sipërfaqen prej 1670 m2. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata Themelore kishte kërkuar që të (i) aprovohet kërkesëpadia e tij; (ii) të konstatojë se të paditurit J.N dhe D.N kanë uzurpuar paluajtshmërinë e lartcekur të regjistruar në certifikatën e pronësisë në emër të parashtruesit të kërkesës dhe (iii) ti detyrojë paditurit që t'ia kthejnë këtë pjesë të paluajtshmërisë. Më 24 maj 2013, J.N dhe D.N, në cilësinë e të paditurve- kundërpaditësve kishin parashtruar kundërpadi në Gjykatën Themelore përmes të cilës kishin kërkuar që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës dhe të vërtetohet se J.N është pronar në bazë të mbajtjes-parashkrimit fitues të paluajtshmërisë kontestuese. Më 17 qershor 2015, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit C.nr. 561/12 ndër tjerash kishte (i) refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) kishte aprovuar si pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e të paditurit-kundërpaditësit J.N dhe kishte vërtetuar se ky i fundit është pronar në bazë të mbajtjes-parashkrimit fitues të paluajtshmërisë në sipërfaqe prej 1670 m2 në mes të ngastrës 320/1 dhe 320/2 ashtu siç është përcaktuar me paragrafin 4 të nenit 28 të LMTHPJ-së. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, dhe kjo e fundit përmes Aktgjykimit [Ac.nr. 2837/15], të 29 janarit 2020 kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pathemeltë duke vërtetuar në tërësi konstatimin dhe qëndrimin e Gjykatës Themelore. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit kishte parashtruar revizion në Gjykatën Supreme. Më 2 prill 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. Nr. 360/2020] revizionin e parashtruesit të kërkesës e kishte refuzuar si të pathemeltë.

44. Gjykata po ashtu vëren se pas nxjerrjes së Aktgjykimit [Rev. Nr. 360/2020] të 2 prillit 2021 të Gjykatës Supreme, gjegjësisht më 26 maj 2021, parashtruesi i kërkesës në Prokurorinë e Shtetit kishte parashtruar propozimin për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimeve të Gjykatës Themelore, të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme, për të cilin propozim Prokurori i Shtetit përmes Njoftimit të tij, të 7 qershorit 2021 e kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës se propozimi i tij është i palejuar.

45. Megjithatë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij në mënyrë specifike si vendim të fundit, të nxjerrë në procedurë gjyqësore e ka cekur Aktgjykimin [Rev. Nr. 360/2020] të 2 prillit 2021 të Gjykatës Supreme. Thënë këtë, Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston konstatimet e dhëna përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme duke pretenduar shkelje të të drejtave themelore të tij të garantuara me nenet 24 Barazia para Ligjit]; 46 [Mbrojtja e Pronës] paragrafi 1; dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

46. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me paragrafin 1 të nenit 46 të Kushtetutës për të vazhduar me shqyrtimin e pretendimeve të tij përkitazi me nenet 24 dhe 54 të Kushtetutës.

III. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës

47. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon se atij i është shkelur e drejta në pronë, dhe në lidhje me këtë, në thelb specifikon se ai është pronar legjitim i paluajtshmërisë së lartcekur, e cila në librat kadastralë është e regjistruar në emër të tij. Në kontekst të pretendimit të tij për shkelje të drejtës së tij në pronë, parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të nenit 18 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore dhe paragrafit 1 të nenit 20 dhe paragrafit 1 të nenit 33 të LMTHJP, të vitit 1980.

48. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesit të kërkesës që ndërlidhet me konstatimin e gjykatave të rregullta se i padituri-kundërpaditësi J.N paluajtshmërinë e tij e kishte fituar në bazë të mbajtjes –parashkrimit fitues ashtu siç përcaktohet me paragrafin 4 të nenit 28 të LMTHPJ-së bie në kategorinë e pretendimeve "*të shkallës së katërt*", sepse ngërthen çështje që

ndërlidhen me interpretimin dhe aplikimin e ligjit, përkatësisht "*ligjshmërisë*" dhe jo "*kushtetutshmërisë*".

49. Gjykata ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e *"shkallës së katërt"*, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari",* Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues ***Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS***, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 61).

50. Në këtë drejtim, dhe në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, Gjykata nuk mund, si rregull i përgjithshëm, të vë në dyshim gjetjet dhe konkluzionet e gjykatave të rregullta që kanë të bëjnë me: (i) vërtetimin e fakteve të rastit; (ii) interpretimin dhe zbatimin e ligjit; (iii) pranueshmërinë dhe vlerësimin e provave në gjykim; (iv) drejtësinë substanciale të rezultatit të një kontesti civil; (shih në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020, paragrafi 73).

51. Për sa i përket këtij pretendimit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta, gjegjësisht Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme ofruan arsyetimin përkatës për refuzimin e kërkesëpadisë, ankesës dhe revizionit, respektivisht. Të tri instancat e gjykatave të rregullta vërtetuan se J.N. në cilësinë e të paditurit-kundërpaditësit pronësinë e tij në paluajtshmërinë kontestuese e kishte fituar në bazë të mbajtjes-parashkrimit fitues në pajtim me paragrafin 4 të nenit 28 të LMTHPJ-së.

52. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht rikujton konstatimin e Gjykatës Themelore, e cila ndër tjerash kishte theksuar se: *"Pretendimi i [parashtruesit të kërkesës] se në rastin konkret [parashtruesi i kërkesës] e ka të drejtën e pronësisë së paluejtshmërisë kontestuese dhe të regjistruar në librat publikë, dhe [J.N dhe D.N] kanë uzurpuar*

një pjesë të paluajtshmërisë dhe atë pjesë duhet të ia dorëzojnë [parashtruesit të kërkesës] sepse e mbajnë pa bazë ligjore, si i tillë është i pabazuar, për arsye se [parashtruesi i kërkesës] ka humbur të drejtën ta kërkoj kthimin e e paluajtshmërisë kontestuese në kuptim të dispozitës së nenit 37.1 dhe 2. Të LMTHJ, sepse në bazë të dispozitës së nenit 28.4 të MTHJ-së, [J.N] ka fituar të drejtën e pronësisë në pjesën e paluejtshmërisë të përshkruar si në pikën II, në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, me parashkrimin fitues ngase ka kaluar koha më shumë se 20 vite, që [J.N] e mban këtë pjesë të paluejtshmërisë dhe asnjëherë nuk ka qenë i shqetësuar apo penguar nga [parashtruesi i kërkesës] po pretendim i ndonjë pale të tret, deri në momentin e ushtrimit të padisë dhe se për të fituar e drejta e pronësisë në mënyrë origjinare me mbajtje-parashkrim fitues duhet të plotësohen tri kushte kumulativisht dhe atë: të ekzistoj mbajtja e sendit, që mbajtja e sendit të jetë me mirëbesim dhe që të kaloj koha mbi 20 vite, që sendin ta mbajë më shumë se 20 vite pandërprerë, me bindje të thellë se mban sendin e tij dhe të sillet si pronarë i sendit, çka në rastin konkret [J.N] me provat e administruara arriti ta argumentoj këto kushte me fakte relevante dhe të domosdoshme."

53. Në vazhdim, Gjykata po ashtu i referohet Aktgjykimit [Ac.nr. 2837/15] të 29 janarit 2020 të Gjykatës së Apelit, përmes të cilës kjo e fundit, ndër tjerash kishte theksuar se: "*Në rastin konkret me provat e administruara është provuar dhe kontinuitetit i posedimit dhe kalimit të afatit të nevojshëm për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, pasi paraardhësi i tyre por edhe [J.N dhe D.N] e kanë mbajtur në posedim te papenguar në raport me [parashtruesin e kërkesës] që nga viti 1973, fakt që nuk është kontestuar as nga [parashtruesi i kërkesës], deri në ushtrimin e padisë së kësaj çështjeje, të njëjtit nuk janë shqetësuar as nga paraardhësit e [parashtruesit të kërkesës], andaj përfundimi i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë [J.N dhe D.N] është në pajtim e të plotë me dispozitat materialo-juridike, në këtë rast të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, neni 28, paragrafi 4, dhe se kushtet që rrjedhin nga përmbajtja e dispozitës së cituar për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues në këtë çështje kontestuese, janë plotësuar në mënyrë kumulative, prandaj gjykata ankimore e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm, vendimin e gjykatës së shkallës së parë."*

54. Më tutje, Gjykata po ashtu rikujton se Gjykata Supreme në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës të ngritura në revizionin e tij të parashtruar në këtë gjykatë, në esencë kishte (i) konstatuar se Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale; (ii) vërtetuar se J.N ka qenë në posedim me mirëbesim dhe të papenguar nga të tjerët në paluajtshmërinë kontestuese për më shumë se njëzet (20) vite dhe rrjedhimisht në bazë të mbajtjes-parashkrimit fitues sipas paragrafit 4 të nenit 28 të LMTHPJ ka fituar të drejtën e pronësisë mbi këtë paluajtshmëri; (iii) konstatuar se fakti që paluajtshmëria kontestuese është e evidentuar në emër të parashtruesit të kërkesës, ky nuk paraqet bazë juridike e as mënyrë të fitimit të pronësisë; dhe (iv) arsyetuar se në rastin konkret ishin aplikuar dispozitat e LMTHPJ për arsye se raporti civilo-juridike në mes palëve ndërgjygjëse është krijuar para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore.

55. Përkitazi me pretendimin thelbësor të parashtruesit të kërkesës të ngritur në revizionin e tij se të paditurit –kundërpaditësit [J.N dhe D.N] kishin uzurpuar paluajtshmërinë kontestuese, e cila ishte e evidentuar në librat kadastralë dhe sipas certifikatës së pronësisë ishte regjistruar në emër të tij, Gjykata Supreme arsyetoi se *"[...] vetëm fakti se paluejtshmëria kontestuse evidentueka në emër të [parashtruesit të kërkesës], nuk d.m.th. se kjo paraqet as bazën juridike e as mënyrën e fitimit të pronësisë (iustus titullus-modus aquirendi), ndërsa, në anën tjetër, sikurse rezulton nga shkresat e lëndës, kjo Gjykatë konsideron se [J.N] e ka fituar pronësinë në paluejtshmërinë e më lartë theksuar, në bazë të ligjit përkatësishtë në bazë të institutit të se drejtës civile-parashkrimi fitues-mbajtjes, pra, në mbështetje të dispozitave ligjore të nenit 20 respektivishtë nenit 28.4 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike [...]."*

56. Gjykata sjell sërish në vëmendje se parashtruesi i kërkesës pretendimin e tij për shkelje të së drejtës së tij në pronë, si rezultat i refuzimit të kërkesëpadisë së tij dhe konstatimit të gjykatave të rregullat se J.N ka fituar pronësinë në bazë të mbajtjes-parashkrimit fitues në thelb e mbështet në faktin se paluajtshmëria e kontestuar është e regjistruar në emër të tij dhe se të paditurit-kundërpaditësit këtë pjesë të paluajtshmërisë e kanë mbajtur në keqbesim.

57. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës. Një qëndrim i tillë mbështetet edhe në praktikën e GJEDNJ-së (shih *Van der Mussele kundër Belgjikës*, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 23 nëntorit 1983 dhe *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 9 tetorit 2003).

58. Parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, vetëm për aq sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me "pronën" e tij. Brenda kuptimit të kësaj dispozite, "pronë" mund të jetë "pasuria ekzistuese", duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë "pritshmëri legjitime" që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese KI26/18, parashtruesi i kërkesës *"Jugokoka"* Aktvendimi për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2018, paragrafi 49 ; KI156/18, parashtrues i kërkesës *Verica (Aleksić) Vasić dhe Vojislav Čađenović,* Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 korrikut 2019, paragrafi 52 dhe rastin KI41/19, me parashtrues *Ramadan Koçinaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 15 janarit 2020, paragrafi 60).

59. Në dritën e fakteve të mësipërme, pavarësisht se parashtruesi i kërkesës nuk ka ngritur shprehimisht pretendime që lidhen me gjykimin e drejtë (të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës), Gjykata e konsideron të nevojshme të vë në pah se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqiste argumente dhe dëshmi që ai i konsideronte të rëndësishme për rastin e tij; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shqyrtuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta.

60. Prandaj bazuar si më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur se si vendimi për refuzimin e kërkesëpadisë së tij nga Gjykata Themelore dhe konstatimi i kësaj të fundit se J.N paluajtshmërinë kontestuese, e cila ishte evidentuar në emër të parashtruesit të kërkesës e kishte fituar në bazë të mbajtjes-parashkrimit fitues për më shumë se njëzet (20) vite, vendim ky i vërtetuar edhe nga Gjykata e Apeli dhe ajo Supreme kanë shkelur të drejtën e tij në pronë, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 46 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të tij pronësore, të garantuara me paragrafin 1 të nenit 46 të Kushtetutës është qartazi i pabazuar mbi baza kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

IV. *Përkitazi me nenet 24 dhe 54 të Kushtetutës*

61. Bazuar në atë si më lart, Gjykata vë në pah se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të barazisë para ligjit, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë parashtruesi i kërkesës vetëm ka cekur se "*mendoj se barazia e palëve nuk ka ekzistuar ne rastin konkret*" duke mos elaboruar dhe arsyetuar më tej se si kjo e drejtë e garantuar më Kushtetutë është shkelur në rastin e tij.

62. Ndërsa përkitazi me pretendimin e tij për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se "*Është bere [shkelje] e dispozitës se nenit 54 te Kushtetutës se R. se Kosovës, lidhur me mbrojtjen gjyqësore e te drejtave, ktu me janë shkelur te drejtat njerëzore.*" Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka elaboruar dhe precizuar fare se si ky nen i Kushtetutës është shkelur në rastin e tij, dhe po ashtu nuk saktëson se nëse ky nen është shkelur edhe si rezultat i shkeljes së ndonjë të drejtë tjetër të garantuar me Kushtetutë.

63. Gjykata, në këtë kontekst thekson se, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, ajo vazhdimisht ka theksuar se: se (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih rastet e Gjykatës KI163/18, parashtrues *Kujtim Lleshi*, i cituar më lart, paragrafi 85, dhe KI124/20 parashtrues *MuhamedAli Ceysűlmedine*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 42).

64. Bazuar në si më sipër, Gjykata konsideron se pretendim i i parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 24 dhe 54 të Kushtetutës janë pretendime "*të pambështetura apo paarsyetuara*", dhe rrjedhimisht, të papranueshme siç është përcaktuar përmes nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (d) të Rregullores së punës.

65. Prandaj, dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse, pretendimi (i) lidhur me nenin 46 të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës; ndërsa (ii) lidhur me nenet 24 dhe 54 të Kushtetutës është i papranueshëm si "i pambështetur apo paarsyetuar" siç është përcaktuar përmes nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 39 (1) (d) dhe (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 21 tetor 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Safet Hoxha	Gresa Caka-Nimani

KI189/20, Parashtrues: IPKO Telecommunications L.L.C, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, ARJ-UZPV.nr.17/2020, të 20 janarit 2020, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

KI189/20, Aktgjykim i 20 tetorit 2021, publikuar me 11 nëntor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, Vendim i paarsyetuar gjyqësor*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në cilësinë e ofruesit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, se bazuar në Ligjin për Komunikimet Elektronike dhe për qëllime të interesit publik, është i liruar nga ngarkesa me tatim të pronë të paluajtshme, pretendim ky i cili përtej një Aktgjykimi të Gjykatës Themelore, ishte refuzuar edhe nga Komuna respektive por edhe përmes Aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit dhe Supreme, respektivisht e të cilat parashtruesi i kërkesës i konteston para Gjykatës.

Nga shkresat e lëndës rezulton që pas ngarkimit me pagimin e tatimit në pronën e paluajtshme për "BTS Antena" nga Komuna e Gjakovës, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Bordin Komunal për ankesa në tatim në pasurinë e paluajtshme, me arsyetimin se shqiptimi i faturës së tatimit në pronë është në kundërshtim me nenin 22 (Baza për instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike) të Ligjit për Komunikime Elektronike, në bazë të së cilës dispozitë, i njëjti pretendonte se lirohej nga pagesa e tatimit në pronë. Komuna e Gjakovës e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke lënë në fuqi faturën e tatimit në pronë. Në procedurat para gjykata të rregullta, Gjykata Themelore fillimisht e kishte aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Komunës së Gjakovës, duke e detyruar të njëjtën që ta liroj parashtruesin e kërkesës nga borxhi i tatimit në pronë. Megjithatë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme respektivisht, duke vepruar sipas ankesës së Komunës së Gjakovës dhe më pas, sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruesit të kërkesës, ndryshuan Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke refuzuar përfundimisht pretendimet e parashtruesit të kërkesës, që bazuar në Ligjin për Komunikimet Elektronike, ishte i liruar nga tatimi në pronë.

Para Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës, ndër tjerash, kishte pretenduar se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmes të cilit ishte ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, nuk i plotësonte kriteret e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, sepse nuk kishte sqaruar dallimin në mes taksës në pronë, nga e cila janë të liruara rrjetet e komunikimeve elektronike dhe facilitetet shoqëruese sepse ndërtimi i tyre është në interesin publik sipas Ligjit për Komunikimet Elektronike dhe tatimit në pronë, nga i cili nuk janë

të liruara të njëjtat, sipas Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Parashtruesi i kërkesës iu kishte referuar gjithashtu edhe interpretimit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare sipas të cilit, taksa dhe tatimi i referuar në dy Ligjet respektive kanë kuptimin e njëjtë, dhe operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike janë të liruara nga e njëjtat. Duke marrë parasysh që, sipas parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme vetëm kishte konfirmuar vendimin e Gjykatës së Apelit dhe nuk kishte adresuar dhe as arsyetuar pretendimet e tij të ngritura përmes kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit, para Gjykatës parashtruesi i kërkesës, pretendoi shkelje të se drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me Kushtetutë dhe Konventë Evropiane për Drejtat e Njeriut.
Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, dhe më pas, aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata, bazuar në praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, ndër tjerash, theksoi se mosdhënia e përgjigjeve të qarta dhe të plota përkitazi me pretendime thelbësore dhe përcaktuese të ngritura nga parashtruesi i kërkesës e që ndërlidhen me specifikat dalluese të tatimit në pronë dhe taksës në pronë të paluajtshme të përcaktuara përmes dy ligjeve, Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe Ligjin për Komunikimet Elektronike, respektivisht, nuk është në përputhje me garancitë që ndërlidhen me të drejtën për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me Kushtetutë dhe Konventë Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për pasojë dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejtat në proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke e kthyer të njëjtin në rishqyrtim në Gjykatën Supreme.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI189/20

Parashtrues

IPKO Telecommunications L.L.C.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit ARJ-UZPV. nr. 17/2020, të 20 janarit 2020,
të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania IPKO Telecommunications LL.C, të cilën e përfaqëson avokati Isamedin Dedinca nga Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [ARJ-UZPV.nr.17/2020] e 20 janarit 2020, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.585/2018] e 1 nëntorit 2019, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [A.nr. 2105/14] e 6 shtatorit 2018, të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore)

3. Aktgjykimin e kontestuar parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar me 10 shtator 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj themelore të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin në vijim: KEDNJ) si dhe nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (në tekstin në vijim: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] si dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale), të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 24 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata).

7. Më 30 dhjetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

8. Më 14 janar 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi plotësimin e formularit e kërkesës së Gjykatës.

9. Më 14 janar 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.

10. Më 28 janar 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë plotësimin e kërkuar, përkatësisht formularin e kërkesës së Gjykatës.

11. Më 29 prill 2021, Gjykata kërkoi dosjen e plotë të lëndës nga Gjykata Themelore.

12. Më 30 prill 2021, Gjykata Themelore dorëzoi dosjen e lëndës në Gjykatë.

13. Më 17 maj 2021, Gjykata njoftoi Komunën e Gjakovës në cilësi të palës së interesuar, për regjistrimin e kërkesës.

14. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese.

15. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

16. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, caktoi Gjyqtaren Selvete Gërxhaliu Krasniqi si anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu. Gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi u caktua kryesuese e Kolegjit shqyrtues.

17. Më 28 maj 2021, Komuna e Gjakovës përmes emailit dorëzoi në Gjykatë komentet e saj.

18. Më 25 qershor 2021, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani filloi detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

19. Më 30 qershor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe kërkoi plotësimin e raportit.

20. Më 20 tetor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

21. Më 7 shkurt 2014, Komuna e Gjakovës i kishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës Faturën e Tatimit në pronë me nr. [102120/30227493] të 14 janarit 2014, për BTS Antena për vitin 2014, me të cilën parashtruesi i kërkesës detyrohej që të paguaj tatimin në pronë për vitin 2014 në shumën prej 4.160 euro, deri me 30 qershor të 2014, kështin e dytë në shumën prej 4.160 euro deri me 31 dhjetor të vitit 2014 si dhe të paguaj menjëherë borxhin për vitet e kaluara në shumën prej 42.608 euro, e gjithsej në total shumën prej 50,928.00 euro.

22. Më 28 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë pranë Bordit Komunal për ankesa në tatim në pasurinë e paluajtshme, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa e Kuvendit Komunal të Gjakovës, me arsyetimin se shqiptimi i faturës së tatimit në pronë është në kundërshtim me parimin e përgjithshëm të ligjshmërisë nga neni 3 (Parimi i ligjshmërisë) i Ligjit të Procedurës Administrative si dhe paraqet shkelje të dispozitës së paragrafit 6 të nenit 22 (Baza për instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike) të Ligjit për Komunikime Elektronike (në tekstin në vijim: LKE) në bazë të së cilës dispozitë taksa e pronës së paluajtshme nuk zbatohet për rrjetat e komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese, duke përfshirë edhe atë për rrjetat mobile (GSM), stacionet bazë, satelitet dhe infrastrukturën nëntokësore.

23. Më 7 mars 2014, Bordi Komunal për shqyrtimin e ankesave për tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna e Gjakovës përmes Vendimit Nr. [03-430-2026] (i) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) la në fuqi faturën e tatimit në pronë [102120/30227493] të 14 janarit 2014.

24. Më 17 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës përmes padisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore) inicioi konflikt administrativ kundër të padituës Komuna e Gjakovës, për shkak të shkeljeve procedurale, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin e aprovimit si të bazuar të padisë si dhe anulimin e vendimit të lartcekur të Komunës së Gjakovës.

25. Më 4 korrik 2016, Komuna e Gjakovës në cilësinë e palës së interesuar parashtron përgjigje në padi duke kontestuar në tërësi pretendimet e parashtruesit të kërkesës si të pabazuara.

26. Më 6 shtator 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr. 2105/14]: (i) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii)

anuloi Aktvendimin nr. [03-430-2026] e 7 marsit 2014, të Komunës së Gjakovës – Bordi Komunal për Ankesa; dhe (iii) obligoi Komunën e Gjakovës-Bordi Komunal për shqyrtimin e ankesave për tatimin në pronën e paluajtshme, që parashtruesin e kërkesës, ta liroj nga borxhi i tatimit në pronë përfshirë kamatën dhe ndëshkimet sipas faturave nr. [102120/30227493] të 14 janarit 2014.

27. Më 19 tetor 2018, e paditura Komuna e Gjakovës, në cilësi të palës së interesuar, parashtron ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave të ligjit të Procedurës Administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar anulimin e Aktgjykimit të ankimuar dhe kthimin e çështjes gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

28. Më 1 nëntor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.585/2018]: (i) aprovoi si të bazuar ankesën e palës së interesuar, si dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore; (ii) refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me të cilën kishte kërkuar anulimin e vendimit Nr. [03-430-2026] të 07 marsit 2014, të palës së interesuar-Komuna e Gjakovës; (iii) Mbeti në fuqi vendimi nr. [03-430-2026] i 07 marsit 2014, i Komunës së Gjakovës.

29. Më 22 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (në tekstin në vijim: ARKEP) kërkesën për interpretimin e dispozitës së nenit 22 paragrafi 6 të LKE-së. Më 9 dhjetor 2019, ARKEP i dorëzoi parashtruesit të kërkesës Memo-n Zyrtare [nr. 642\2\19] të interpretimit të nenit 22 paragrafi 6 të LKE-së, ku theksonte që:

> *"në interpretimin e ARKEP është më se e qartë që kjo dispozitë ka të bëjë me tatimin në pronën e paluajtshme.*
> *[...]*
> *[...] çfarëdo tarife e vendosur ndaj ofrueseve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përveç atyre te referuara ne Ligj, rezulton të jetë në kundërshtim me Ligjin dhe me ndikim negativ për shtrirjen e infrastrukturës së operatorëve të rrjetit të komunikimeve elektronike.*
> *<u>ARKEP edhe njëherë konfirmon se Neni 22 par. 6 i Ligjit për Komunikime Elektronike ka të bëjë me tatimin në pronën e paluajtshme.</u>"*

30. Më 10 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës dhe

zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që: Kërkesa e parashtruesit të miratohet si e bazuar, si dhe të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit. Parashtruesi i kërkesës theksonte që Gjykata e Apelit nuk dha asnjë arsyetim se çfarë nënkupton taksa në pronë e përcaktuar me dispozitën e nenit 22 paragrafi 6 të LKE-së, pse nuk është e njëjtë taksa në pronë dhe tatimi në pronë, ku qëndron dallimi, për çfarë aplikohet taksa në pronë dhe për çfarë aplikohet tatimi në pronë në mënyrë që arsyetimi i këtij aktgjykimi t'i përmbaj arsyet mbi faktet vendimtare dhe se për cilat arsye Gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte bashkangjitur si provë në këtë kërkesë edhe Memo-n Zyrtare të ARKEP-it, e cila specifikonte që taksa në pronë dhe tatimi janë të njëjta në kuptim të nenit 22 paragrafi 6.

31. Më 21 dhjetor 2019, Komuna e Gjakovës përmes kundërshtimit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të parashtruesit e kërkesës, i kontestoi në tërësi pretendimet e tij, me propozimin që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Ndër të tjera, Komuna e Gjakovës kërkoi nga Gjykata Supreme që e njëjta të kërkojë nga *Qeveria e Republikës së Kosovës –Ministria e Financave, interpretim të nenit 22 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-109 Ligji për Komunikimet Elektronike apo çka nënkuptohet me termin "taksë në pronë" dhe çka me termin "tatim në pronë".*

32. Më 20 janar 2020, Gjykata Supreme e Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata Supreme) përmes Aktgjykimit [ARJ-UZVP. nr. 17/2020] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër Aktgjykimit [AA. UZH. Nr. 585/2018] të 1 nëntorit 2019, të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, ARJ-UZPV.nr.17/2020, i 20 janarit 2020, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara përmes neneve 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së si dhe nenin 10 të DUDNJ-së.

34. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon që procedura gjyqësore e zhvilluar në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, ishte e parregullt sepse Vendimet gjyqësore ishin marrë me shkelje

thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, u mungojnë arsyet mbi faktet vendimtare, arsyetimi nuk i përmban kërkesat e parashtruesit, prandaj këto vendime janë arbitrare dhe paraqesin edhe cenim të të drejtave individuale të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, nenit 10 të DUDNJ-së, si dhe Nenit 6 të KEDNJ-së.

35. Parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata e Apelit ka bërë zbatim arbitrar të dispozitave të paragrafit 3.1 të nenit 8 (Lirimi nga tatimi mbi pronën e paluajtshme) të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, sepse nuk ka arsyetuar se cili është dallimi midis tatimit në pronën e paluajtshme dhe taksës në pronën e paluajtshme të paraparë me dispozitën e nenit 22 paragrafi 6 të LKE-së, për çfarë aplikohet taksa në pronë dhe për çfarë aplikohet tatimi në pronë. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata e Apelit nuk ka dhënë asnjë arsyetim se përse nuk qëndron konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se Ligji për tatimin në pronën e paluajtshme nuk mund zbatohet si *Lex Specialis* në këtë rast, por si i tillë (*Lex Specialis*) duhet të trajtohet Ligji për Komunikimet Elektronike sipas parimit ligjor "*lex specialis derogat legi generali*".

36. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson se në një rast tjetër (Rasti A.nr.1073/14, AA.ru.52/2016) për të njëjtën çështje pra çështjen e tatimit në pronë (për rrjetin e komunikimeve elektronike) të shqiptuar parashtruesit të kërkesës nga Komuna e Suharekës, gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesit IPKO Telecommunication.LLC, lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, ashtu që e kishte detyruar të paditurën që gjatë marrjes së vendimit të merr parasysh Memon Zyrtare të lëshuar nga ARKEP dhe se Gjykata e Apelit e ka vërtetuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa në rastin konkret, në kundërshtim me qëndrimin juridik të saj në rastin e paracekur, Gjykata e Apelit, nuk e mori parasysh Memon e ARKEP dha nuk dha asnjë arsyetim se përse nuk duhet të merret parasysh në këtë rast përderisa më herët kishte vendosur ndryshe.

37. Në vijim parashtruesi i kërkesës thekson se edhe Gjykata Supreme nuk arsyetoi se çfarë nënkupton taksa në pronë e përcaktuar me dispozitën e nenit 22 paragrafi 6 të LKE-se, pse nuk është e njëjtë taksa në pronë dhe tatimi në pronë, ku qëndron dallimi, për çfarë aplikohet taksa në pronë dhe për çfarë aplikohet tatimi në pronë, si dhe nuk e trajtoi çështjen se LKE duhet të trajtohet si *Lex Specialis* në këtë rast sipas parimit "*Lex specialis derogat legi generali*".

38. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që Gjykata Supreme nuk e morri parasysh provën e ofruar nga ana e tij, lidhur me interpretimin

e LKE-së, përkatësisht të Memo-s Zyrtare të ARKEP-it, të 6 dhjetorit 2019 si autoritet kompetent për interpretimin e dispozitave të LKE-së, e ku thekson se taksa në pronë siç është përcaktuar me dispozitën e Nenit 22 paragrafi 6 i LKE-së ka të bëjë me tatimin në pronë dhe si e tillë operatorët janë të liruar nga ky lloj tatimi.

39. Në ndërlidhje me çështjet e ngritura më lartë, parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykata gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 8 paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.03/L-204 për Tatim në Pronën e Paluajtshme ku përcaktohet se "lirimi nga tatimi nuk vlen pasi prona shfrytëzohet ose mbahet për shfrytëzimin e veprimtarisë komerciale dhe për krijimin e të ardhurave", pasi qe kjo dispozitë ligjore vlen për bizneset tjera që pronën e shfrytëzojnë ose e mbajnë për veprimtari komerciale, mirëpo tek parashtruesi situata është krejtësisht tjetër, sepse ai është operator i cili ofron shërbime të interesit publik dhe me ligjin special i cili rregullon në tërësi fushën e komunikimeve elektronike është përjashtuar taksa në pronë/tatimi në pronë për pajisjet dhe stabilimentet e tjera, të përcaktuara si në dispozitën e nenit 22 paragrafi 6 të LKE-së.

40. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu përmend disa raste të Gjykatës për sa i përket praktikës së Gjykatës për vendim të paarsyetuar, ku përshihen rastet KI135/14, me parashtrues *IKK Classic*, KI18/16, me parashtrues *Bedri Salihu*, KI31/17, me parashtrues *Shefqet Berisha*, KI97/16, me parashtrues *IKK Classic*, KI35/18, me parashtrues *Bayerische Versicherungsverbrand*.

41. Përfundimisht parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë që (i) Kërkesa e Parashtruesit IPKO Telecommunications L.L.C është e pranueshme; (ii) Të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të Parashtruesit të garantuara me Nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të Kushtetutës, Nenin 10 të Deklaratës Universale dhe nenin 6 të Konventës Evropiane, si rezultat i shkeljeve nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e të drejtave të garantuara me këto instrumente dhe Ligjin për Procedurën Kontestimore; (iii) Të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ-UZVP.nr.17/2020] të 20 janarit 2020, të kundërshtuar me këtë kërkesë dhe çështjen ta kthej në rivendosje në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Komentet e palës së interesuar

42. Komuna e Gjakovës në cilësinë e palës së interesuar parashtroi komentet e saj të titulluara “përgjigje në kërkesë”, përmes së cilës konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht

kompanisë “IPKO TELECOMM UNICATIONS L.L.C” janë tërësisht të pa bazuara.

43. Komuna e Gjakovës në vijim theksoi që në rastin konkret ka vendosur në bazë të përcaktimit ligjor të Ligjit për Tatimin në Pronë Nr. 06/L-005, i cili ka përparësi në aplikim. Gjithashtu, Komuna e Gjakovës thekson që për të hequr dilemat e dallimit të termeve “tatimi në pronë” dhe “taksa në pronë” duhet të kërkohet nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave që të bëhet interpretimi i nenit 22 paragrafi 6 i Ligjit për Komunikime Elektronike.

44. Përfundimisht, Komuna e Gjakovës e kundërshton në tërësi kërkesës e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe në kundërshtim me gjendjen faktike dhe juridike, me propozimin që Gjykata në nxjerr Aktvendim përmes të cilit: (i) TA DEKLAROJË, kërkesën e "IPKO TELECOMMUNICATIONS L.L.C" të pa pranueshme; (ii) T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve; (iii) TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

[...]

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
(...)

Ligji Nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme

Neni 8
Lirimi nga tatimi mbi pronën e paluajtshme

1. Këto institucione dhe organizata të mëposhtme lirohen nga tatimi mbi pronën për pronën që e posedojnë ose shfrytëzojnë:

[...]

3. Lirimi nga tatimi sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk vlen kur:

3.1. prona shfrytëzohet ose mbahet për shfrytëzimin e veprimtarisë komerciale dhe për krijimin e të ardhurave;

Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike

Neni 22
Baza për instalimin e infrastrukturës
së komunikimeve elektronike

6. Ndërtimi i rrjetave publike të komunikimeve elektronike si dhe faciliteteve shoqëruese është në interesin publik. Taksa e pronës së paluajtshme nuk zbatohet për rrjetat e komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese, duke përfshirë edhe ato për rrjetat mobile (GSM), stacionet bazë, satelitët dhe infrastruktura nëntokësore.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

45. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

46. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21

"[...]

5. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

Neni 113

"*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

47. Gjykata më tej i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç specifikohen në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet), të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]."

48. Fillimisht, Gjykata sqaron se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u referuar në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastet e Gjykatës, KI10/20, me parashtrues *"Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" SH. A. – Njësia Malësia e Re Prizren,* Aktvendim për Papranueshmëri i 5 tetorit 2020, paragrafi 35; rasti KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

49. Më tutje, për sa i përket përmbushjes së kritereve të mësipërme procedurale për pranueshmërinë e kërkesave kushtetuese, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.17/2020 e 20 janarit 2020, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me Ligj. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ajo pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

50. Gjykata në fund vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës. Gjykata më tej thekson se nuk është e papranueshme në asnjë bazë tjetër. Prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme (shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, paragrafi 144).

Meritat e kërkesës

51. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së si dhe nenin 10 të DUDNJ-së.

52. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, për ngarkimin e pagimit të tatimit mbi pronën e paluajtshme për BTS Antena nga Komuna e Gjakovës. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë pranë Bordit Komunal për ankesa në tatim në pasurinë e paluajtshme, me arsyetimin se shqiptimi i faturës së tatimit në pronë është në kundërshtim me dispozitën e paragrafit 6 të nenit 22 (Baza për instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike) të LKE-së, në bazë të së cilës dispozitë i njëjti pretendonte se lirohej nga pagesa. Komuna e Gjakovës refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke lënë në fuqi faturën e tatimit në pronë. Në vijim Gjykata Themelore e kishte aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër Komunës së Gjakovës, duke e detyruar të njëjtën që ta liroj nga borxhi i tatimit në pronë. Duke vepruar sipas ankesës përkatëse të Komunës së Gjakovës, Gjykata e Apelit, aprovon si të bazuar ankesën e saj me ç'rast refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, në të cilën theksonte se Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit i mungonte arsyetimi mbi faktet vendimtare, përkatësisht arsyetimi se çfarë nënkupton *"taksa në pronë"*, si dhe kishte bashkëlidhur si provë edhe Memon Zyrtare të ARKEP-it, e cila specifikonte që taksa në pronë dhe tatimi janë të njëjta në kuptim të nenit 22 paragrafi 6 të LKE-së. Kjo kërkesë u refuzua si e pabazuar nga Gjykata Supreme e cila theksoi se Komuna e Gjakovës nuk e ka detyruar parashtruesin e kërkesës për taksën e pronës, por e ka faturuar për tatimin në pronë, mirëpo e njëjta nuk kishte sqaruar se çka është taksa në pronë, si dhe nuk e kishte trajtuar Memon zyrtare të ARKEP-it. Parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës i konteston konstatimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, duke pretenduar, në thelb shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të cilat kanë rezultuar me vendim të pa arsyetuar si rezultat i mos dhënies së një përgjigje specifike në pretendimin vendimtar se çka është taksa në pronë, e cila do të mundësonte përjashtimin e tij nga detyrimi për pagim të tatimit të

pronës. Në vijim Gjykata do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.

53. Parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, janë shkelur të drejtat e tij për një *vendim të arsyetuar*, sepse nuk i janë adresuar argumentet e tij thelbësore, të cilat ishin qenësore për vlerësimin e saktë të gjendjes faktike, përkatësisht përjashtimin e tij nga detyrimi i pagimit të tatimit në pronën e paluajtshme, si dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale, përkatësisht nenit 22 paragrafi 6 i LKE-së. Pra, Gjykata vëren se pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me mos arsyetimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme si rezultat i mos adresimit të argumenteve të tij thelbësore.

54. Gjykata thekson se e drejta për një vendim të arsyetuar garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe zbatimi i saj, është interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) përmes praktikës së saj gjyqësore. Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

(i) Parimet e përgjithshme mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar siç është zhvilluar me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së

55. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; Buzescu kundër Rumanisë, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit

2007). Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj,* Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic,* Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019;KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019; KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverbrand*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020).

56. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastet e Gjykatës KI09/20, me parashtrues *"SUVA" Rechtsabteilung*, Aktgjykim i 31 majit 2021, paragrafi 56; KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* të cituar më lart, paragrafi 139).

57. Gjykata, po ashtu thekson se, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, e cila mbështetet në praktikën gjyqësorë të GJEDNJ-së, gjatë vlerësimit të parimit, i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih, në mënyrë të ngjashme, rastet e GJEDNJ-*së Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Morerira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi,* Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

58. Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së theksohet se funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. (shih *mutatis mutandis,* rastet e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, kërkesa nr. 49684/99, 27 shtator 2001, paragrafi 30; *Tatishvili kundër Rusisë*, kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58; dhe *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 37801/97, Aktgjykimi i 1 korrikut 2003, paragrafi 37).

59. Megjithatë, edhe pse GJEDNJ pohon se neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, obligon gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, ajo gjithashtu ka konstatuar se kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42).

60. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. (rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, cituar më lartë, paragrafi 42).

61. Prandaj, nga gjykatat kërkohet të shqyrtojnë: argumentet kryesore të palëve ndërgjyqëse (shih rastet e GJEDNJ-së *Buzescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005, paragrafi 67; *Donadze kundër Gjeorgisë,* kërkesa nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 marsit 2006, paragrafi 35); kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara nga Konventa dhe Protokollet e saj, të cilat kërkohet që të shqyrtohen me shumë rigorozitet dhe kujdes të veçantë (shih rastet e GJEDNJ-së: *Fabris kundër Francës*, kërkesa nr. 16574/08, Aktgjykim i 7 shkurtit 2013 paragrafi 72; *Wagner dhe JMWL kundër Luksemburgut*, kërkesa nr. 76240/01, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).

62. Megjithatë, GJEDNJ gjithashtu ka vërejtur se, edhe pse gjykatat kanë liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve në një rast të veçantë dhe në pranimin e provave në mbështetje të parashtresave të palëve, një gjykatë vendore është e detyruar të justifikojë aktivitetet

duke dhënë arsyet për vendimet e saj. (Rasti i GJEDNJ-së shih *Suominen kundër Finlandës*, cituar më lartë, paragrafi 36).

63. Prandaj, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument (shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lartë, paragrafi 61), argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen. (shih rastet e GJEDNJ-së *Buzescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 61302/00, Aktgjykimi i 24 majit 2005, paragrafi 63; *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25). Po ashtu, dhënia e një arsyeje për një vendim që nuk është mirë e bazuar në ligj, nuk do të përmbushë kriteret e nenit 6 të KEDNJ-së.

64. Në fund, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së saj gjyqësore ku ajo konsideron që arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe reflektimeve kur të merren parasysh provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i Gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI72/12, me parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61, dhe KI135/14, me parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58).

65. Në vijim, kur pretendimi i palës është vendimtar për rezultatin e procedurës, i njëjti kërkon një përgjigje specifike dhe shprehimore (shih rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, paragrafi 30; *Hiro Balani kundër Spanjës*, paragrafi 28; dhe krahaso *Petrović dhe të tjerët kundër Malit të Zi*, paragrafi 43).

66. Në rastin *Hiro Balani*, parashtruesja kundërshtoi padinë për heqjen e markës së saj tregtare nga regjistri, ndër të tjera, me një parashtresë të bazuar në përparësinë e një marke tjetër që ajo zotëronte. Ky parashtrim është bërë me shkrim para gjykatave të rregullta dhe ishte formuluar në mënyrë mjaft të qartë dhe të saktë. Një dëshmi zyrtare ishte paraqitur me të si dëshmi. Gjykata Supreme, e cila prishi vendimin e shkallës së parë dhe dha një vendim të ri mbi bazueshmërinë, ishte e detyruar, sipas ligjit procedural të zbatueshëm të rishikonte të gjitha parashtrimet e bëra gjatë procedurave, pasi ato kishin qenë "subjekt i argumentit".

(ii) Zbatimi i parimeve të përmendura më lart në rastin e tanishëm

67. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, nuk arrin të kuptojë pse i mohohen të drejtat e tij për lirim nga pagesa e tatimit në pronën e paluajtshme, duke marrë parasysh që pretendimet thelbësore të tij nuk janë adresuar dhe as nuk janë arsyetuar me Aktgjykimin e kontestuar. Në veçanti parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme kishte dhënë vendim të pa arsyetuar si rezultat i mos dhënies së një përgjigje specifike në pretendimin vendimtar se çka është taksa në pronë, e cila do të mundësonte përjashtimin e tij nga detyrimi për pagim të tatimit/taksës së pronës.

68. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përgjatë procedurave gjyqësore në gjykatat e rregullta, përkatësisht në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, ka pretenduar se nuk ka marrë vendim të arsyetuar në lidhje me atë se çfarë nënkupton lirimi nga taksa në pronën e paluajtshme të përcaktuar me dispozitën e Nenit 22 paragrafi 6 të LKE-së, pse nuk është e njëjtë taksa në pronë dhe tatimi në pronë, ku qëndron dallimi ndërmjet tyre, për çfarë aplikohet taksa në pronë, si dhe nuk është trajtuar çështja që LKE duhet të trajtohet si *Lex Specialis* në raport me Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, sipas parimit "*Lex specialis derogat legi generali*". Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që Gjykata Supreme nuk e morri parasysh provën vendimtare të ofruar nga ana e tij, lidhur me interpretimin e LKE-së, përkatësisht të Memo-s Zyrtare të 6 dhjetorit 2019, të ARKEP-it, si autoritet kompetent për interpretimin e dispozitave të LKE-së, e ku thekson se taksa në pronë siç është përcaktuar me dispozitën e Nenit 22 paragrafi 6 i LKE-së ka të bëjë me tatimin në pronë dhe si e tillë operatorët janë të liruar nga ky lloj tatimi.

69. Nga shkresat e lëndës Gjykata vëren se Gjykata e Apelit lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës kishte dhënë këtë arsyetim:

> *"Gjykata e shkallës së parë gabimisht është bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike, përkatësisht neni 22 par.6, i cili përcakton se: "Ndërtimi i rrjetave publike të komunikimeve elektronike si dhe faciliteteve shoqëruese është në interesin publik. Taksa e pronës së paluajtshme nuk zbatohet për rrjetat e komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese, duke përfshirë edhe ato për rrjetat mobile (GSM), stacionet bazë, satelitët dhe infrastruktura nëntokësore". Kjo dispozitë ligjore nuk mund të zbatohet në rastin konkret, për arsye se dispozita e tillë ka të bëjë me taksën e pronës dhe jo me tatimin në pronë. E paditura ka faturuar paditësin për BTS Antena të vendosura në Komunën e Gjakovës, pra*

shfrytëzimi i veprimtarisë komerciale përmes të cilave shitet shërbimi i internetit dhe televizion, krijimi i të ardhurave. Me nenin 3 par.1 pika 1, të Ligjit nr.03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i cili përcakton se: "1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.1. Pronë e paluajtshme -toka dhe ndërtesat, stabilimentet, godinat nën sipërfaqen e tokës dhe mbi sipërfaqen e tokës dhe që janë të lidhura me tokën. Në pronën e paluajtshme përfshihen njësitë brenda ndërtesave, siç janë banesat, zonat për qëllime komerciale dhe industriale", ndërsa neni 8 paragrafi 3.1 përcakton se: "3. Lirimi nga tatimi sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk vlen kur: 3.1. prona shfrytëzohet ose mbahet për shfrytëzimin e veprimtarisë komerciale dhe për krijimin e të ardhurave", andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura dhe duke marr parasysh faktin se e paditura nuk e ka obliguar paditësin për taksën e pronës por e ka faturuar paditësin për tatimin në pronë, për BTS Antena të vendosura në Komunën e Gjakovës sepse, nga këto antena shitet shërbimi i internetit dhe televizionit, nga të njëjtat krijohen të ardhura për paditësin, dhe me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nuk është paraparë lirimi nga tatimi në pronë për këtë lloj të veprimtarisë."

70. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e saj [ARJ-UZVP.nr. 17/2020] të 20 janarit 2020, në përpjekje për të adresuar pretendimin vendimtar të parashtruesit të kërkesës, nuk e qartëson se çka është taksa në pronë të paluajtshme dhe pse parashtruesi nuk mund të lirohet nga detyrimi i pagimit të tatimit në pronë të ngarkuar nga Komuna e Gjakovës. Në këtë drejtim Gjykata Supreme thekson si në vijim:

Neni 22 par 6 i Ligj it nr.04/L-l 09 për Komunikimet Elektronike përcakton se ndërtimi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike si dhe faciliteteve shoqëruese është në interesin publik. Taksa e pronës së paluajtshme nuk zbatohet për rrjetat e komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese, duke përfshirë edhe ato për rrjetat mobile (GSM), stacionet bazë, satelitët dhe infrastruktura nëntokësore.

Me nenin 3.1 të Ligjit nr.03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i cili përcakton se shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: Prona e paluajtshme-toka dhe ndërtesat, stabilimentet, godinat nën sipërfaqen e tokës dhe mbi sipërfaqen e tokës dhe që janë të lidhura me tokën. Në pronën e paluajtshme përfshihen njësite brenda ndërtesave, siç janë banesat, zonat për

qëllime komerciale dhe industriale. Neni 2 i këtij ligj i cakton tatimin mbi pronën e paluajtshme dhe parashtron standardet dhe procedural të cilat duhet ti respektojnë komunat gjatë administrimit të këtij tatimi. Ndërsa neni 8.1 parashikon se cilat institucione dhe organizata lirohen nga tatimi mbi pronën që e posedojnë ose e shfrytëzojnë. Paragrafi 3 parashikon se lirimi nga tatimi sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk vlen kur prona shfrytëzohet ose mbahet për shfrytëzimin e veprimtarisë komerciale dhe për krijimin e të ardhurave.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit nr.04/L-109 dhe 03/L-204, Gjykata Supreme konsideron se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vepruar drejtë kur ka ndryshuar Aktgjykimin e Divizionit Fiskal të Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, [A.U.nr.21 05/2014] dt. 07.09.20 18, duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit 'Ipko Telecom.' LLC me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të padituës _ Komuna e Gjakovës, nr.03-430-2026 dt. 07.03.2014, dhe duke e lënë në fuqi këtë vendim. Në rastin konkret, e paditura nuk e ka obliguar paditësin për taksën e pronës (sipas nenit 22.6 të Ligjit m.04/L-109 për Komunikimet Elektronike), por e ka faturuar paditësin për tatimin në pronë, për antenat BTS të vendosura në Komunën e Gjakovës, nëpërmjet të cilave shitet shërbimi i internetit dhe televizionit, nga të njëjtat krijohen të ardhura për paditësin, dhe me Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nuk është paraparë lirimi nga tatimi në pronë për këtë lloj të veprimtarisë (neni 8 par 3 pika 3).

71. Megjithatë, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk i adreson pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe nuk jep arsyetim adekuat se cili është dallimi ndërmjet tatimit në pronë dhe taksës në pronë, për çfarë aplikohet taksa në pronë të paluajtshme, si dhe nuk është trajtuar pretendimi që LKE duhet të trajtohet si *Lex Specialis* në raport me Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Gjithashtu, Gjykata Supreme nuk e trajtoi Memo-n zyrtare të ARKEP-it, në të cilën theksohej që *"taksa në pronë siç është përcaktuar me dispozitën e Nenit 22 paragrafi 6 i LKE-së ka të bëjë me tatimin në pronë dhe si e tillë operatorët janë të liruar nga ky lloj tatimi."* Përcaktimi i qartë se cili ligj është special në rrethana të ngjashme, çka është taksa në pronë të paluajtshme janë vendimtare për parashtruesin e kërkesës dhe gjithashtu edhe subjektet ekonomike, pasi që ky arsyetim përcakton se a detyrohet parashtruesi i kërkesës të paguaj apo jo tatimin në pronë të paluajtshme.

72. Në të vërtetë, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ka shpjeguar pse parashtruesi i kërkesës nuk ka fituar të drejtën e lirimit nga pagesa e tatimit në pronën e paluajtshme në kontekst të dhënies së përgjigjes ndaj pretendimeve vendimtare të parashtruesit të kërkesës që (i) taksa në pronë të paluajtshme dhe tatimi në pronë janë të njëjta, (ii) LKE duhej të zbatohej në rastin e parashtruesit të kërkesës dhe (iii) mos përgjigja lidhur me Memon zyrtare të ARKEP-it, e cila konfirmon që taksa në pronë e përcaktuar në nenin 22 paragrafi 6 i LKE-së, ka të bëjë me tatimin në pronë.

73. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës të vendosë se cila do të ishte mënyra më e përshtatshme për gjykatat e rregullta që të merren me argumentet e ngritura. Megjithatë, Gjykata konsideron që Gjykata Supreme, duke mos bërë dallimin se çka përcakton taksa në pronën e paluajtshme të përcaktuar me nenin 22 paragrafi 6 të LKE-së, duke e shmangur arsyetimin e dhënë në Memon zyrtare të ARKEP-it, e shmang pothuajse në tërësi çështjen, edhe pse ishte specifike, relevante, e rëndësishme dhe vendimtare, me ç' rast nuk i plotëson detyrimet e saj sipas nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së. (Shih rasti i GJEDNJ-së *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykimi i 18 korrikut 2006, paragrafi 25).

74. Prandaj, duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konsideron që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk i ka dhënë arsye të mjaftueshme parashtruesit të kërkesës se përse mohohen të drejtat e tij të pretenduara për lirimin nga tatimi mbi pronën e paluajtshme. Rrjedhimisht, ai nuk i ka plotësuar kriteret e drejtësisë siç kërkohet me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih rasti i GJEDNJ-së *Grădinar kundër Moldavisë*, kërkesa nr. 7170/02, Aktgjykimi i 8 prillit 2008, paragrafi 115).

75. Gjykata konsideron se pamundësia e Gjykatës Supreme për të dhënë përgjigje të qarta dhe të plota që kanë të bëjnë me specifikat dalluese të tatimit në pronë dhe taksës në pronë të paluajtshme, paraqet shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për t'u dëgjuar dhe të drejtës për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Pra, e drejta për një vendim të arsyetuar përtej faktit që pretendimi duhet të jetë pretendim thelbësor, përcaktues dhe vendimtar për fitimin apo mosfitimin e të drejtës së pretenduar, i njëjti duhet të shpërfaqë gjithashtu që parashtruesi është dëgjuar dhe ka marrë mjaftueshëm sqarime se pse nuk e gëzon të drejtën e pretenduar.

76. Në këtë aspekt, Gjykata përsërit se GJEDNJ, ndër të tjera, në Aktgjykimin *Hiro Balani*, cituar me lart, dhe specifikisht në rastin

Donadze kundër Gjeorgjisë (kërkesa nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 marsit 2006, paragrafi 35) mori qëndrimin se gjykatat vendore nuk kishin kryer një shqyrtim të plotë dhe serioz të pretendimeve vendimtare dhe përcaktuese të parashtruesit të kërkesës. Thënë këtë, edhe nëse gjykatave nuk mund t'u kërkohet të deklarojnë bazat për refuzimin e çdo argumenti të një pale, megjithatë ato nuk përjashtohen nga shqyrtimi dhe dhënia e arsyetimit të duhur ndaj pretendimeve kryesore dhe vendimtare të ngritura prej parashtruesit të kërkesës.

77. Tutje, Gjykata vëren se një arsyetim i mjaftueshëm dhe i qartë në lidhje me *"taksën në pronë të paluajtshme"* nuk iu dha parashtruesit të kërkesës në aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, përkundrazi, ky pretendim vendimtar dhe përcaktues i tij se neni 22 i LKE-së e liron nga pagesa e tatimin në pronë, si pretendim kryesor dhe përcaktues, mbeti i pa trajtuar mjaftueshëm.

78. Në këtë drejtim, Gjykata vë në pah se nuk është në detyrën e Gjykatës Kushtetuese të ekzaminojë deri në çfarë mase janë të arsyeshme pretendimet e parashtruesve në procedurat pranë gjykatave të rregullta. Megjithatë, drejtësia procedurale e kërkon që pretendimeve thelbësore të ngritura nga palët në gjykatat e rregullta duhet dhëne përgjigje në mënyrën e duhur - posaçërisht nëse kanë të bëjnë me pretendimin vendimtar që në rastin konkret i referohen çështjes së lirimit nga taksa në pronë të paluajtshme, e cila sipas pretendimit të parashtruesit është e njëjtë me tatimin në pronë.

79. Prandaj, duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme vërtetoi qëndrimin e gjykatës së Apelit, pa u përgjigjur në pretendimin specifik të parashtruesit të kërkesës në lidhje me të drejtën e tij për t'u liruar nga taksa në pronë të paluajtshme e cila sipas pretendimit të tij është e njëjtë me tatimin në pronë.

80. Në pajtim me çështjet e lartë theksuara, duhet të konstatohet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [ARJ-UZVP. nr. 17/2020] i 20 janarit 2020, nuk ka plotësuar kriteret e një *"gjykimi të drejtë"* sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar.

81. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se ky përfundim ekskluzivisht ka të bëjë me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme nga këndvështrimi i mjaftueshmërisë së arsyetimit që ndërlidhet me pretendimet thelbësore dhe përcaktuese të parashtruesit të kërkesës, dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit. Në

këtë kontekst, Gjykata thekson se konstatimi i saj se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të së drejtës së parashtruesit për vendim të arsyetuar gjyqësor, i referohet në mënyrë specifike vetëm pretendimit të ngritur nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij në Gjykatë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 21.4, 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, më 20 tetor 2021, me shumicë votash

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [ARJ-UZVP. nr. 17/2020] i 20 janarit 2020, është i pavlefshëm dhe i njëjti kthehet në rivendosje;

IV. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta informojë Gjykatën Kushtetuese sa më shpejt që është e mundur, por jo më larg se 6 (gjashtë) muaj, përkatësisht deri më 18 prill 2022, lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate, në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës;

V. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pritje të respektimit të këtij urdhri;

VI. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VII. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

VIII. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bajram Ljatifi	Gresa Caka Nimani

KI63/21, Parashtruesi i kërkesës: Hysen Metahysa, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Istog, GJ.A. nr. 29/21, të 3 shkurtit 2021, në lidhje me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml. nr. 112/2015 të 22 qershorit 2015

KI63/21, Aktvendim për papranueshmëri i 7 tetorit 2021, publikuar më 12 nëntor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, ratione materiae, qartazi i pabazuar*

Nga shkresat e lëndës rezulton që thelbi i kontestit pranë gjykatave të rregullta kishte të bënte me një procedurë penale të zhvilluar për veprën penale *"marrjes së ryshfetit sipas nenit 343 (2) në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK)"* e cila pretendohet të jetë kryer nga parashtruesi i kërkesës dhe personi I.G, si pjesëtarë të Shërbimit Policor të Kosovës. Në lidhje me këtë, u zhvilluan tri procedura gjyqësore, nga të cilat: procedura e parë gjyqësore kishte të bënte me procedurën penale në të cilën ishte përcaktuar përgjegjësia penale e parashtruesit të kërkesës dhe personit I.G., procedura e dytë gjyqësore kishte të bënte me procedurën penale kundër personit M.M., pronarit të kamionit i cili pretendohet se i kishte dhënë ryshfet personit I.G., bashkëpunëtorit të pretenduar të parashtruesit të kërkesës në kryerjen e veprës penale, ndërsa procedura e tretë gjyqësore kishte të bënte me kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale në të cilën ai dhe personi I.G. ishin dënuar. Në lidhje me procedurën e dytë gjyqësore, Gjykata duhet të theksojë një fakt tjetër të rëndësishëm, përkatësisht se parashtruesi në kërkesë dorëzoi në Gjykatë edhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore nr. 497/13 në lidhje me procedurën penale në të cilën ai nuk paraqitet si palë e drejtpërdrejtë në procedurë, por vetë rezultati i asaj procedure penale kishte implikime të drejtpërdrejta në procedurën e tretë gjyqësore të iniciuar nga parashtruesi me kërkesën për rishikim të procedurës penale. Kjo është procedura penale kundër personit M.M., pronarit të kamionit që pretendohet se i kishte dhënë ryshfet personit I.G., bashkëpunëtorit të pretenduar të parashtruesit të kërkesës në kryerjen e veprës penale, e cila gjithashtu do të paraqitet veçmas në kuadër të përmbledhjes së fakteve.

Pikërisht duke pasur parasysh këtë fakt, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore inicioi procedurë për rishikimin e procedurës penale, duke konsideruar se vetë fakti që personi M.M. ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale *"deklarim i rremë nga neni 307 paragrafi 1 i KPK-së"*, është provë e mjaftueshme të cilën gjykata duhet ta marrë parasysh me rastin e vlerësimit të përmbushjes së kushteve për rihapjen e procedurës penale.

Këtë kërkesë e refuzuan Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, si dhe Gjykata Supreme duke konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet për rihapjen e procedurës për faktin se personi M.M. Është dënuar në një procedurë tjetër penale për shkak të veprës penale *"deklarim i rremë nga neni 307 paragrafi 1 të KPK-së"*, e cila nuk ka pika të përbashkëta me vetë rastin e parashtruesit të kërkesës.

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar para Gjykatës se me vendime të tilla të gjykatave të rregullta i janë cenuar të drejtat kushtetuese të garantuar me nenin 31 si dhe me nenin 32 të Kushtetutës.

Gjykata duke vlerësuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në kontekstin e shkeljeve të cekura të neneve të Kushtetutës, është dashur të përcaktojë nëse procedura gjyqësore përkitazi me rihapjen e procedurës penale është e mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNj-së. Gjykata me rastin e analizimit të pretendimeve të parashtruesit u është referuar parimeve të nenit 6 të KEDNj-së, si dhe praktikës së vet, dhe rrjedhimisht ka konkluduar që gjykatat e rregullta në procedurën sipas kërkesës për përsëritje të procedurës vendosin vetëm lidhur me çështjen nëse kërkesa për përsëritje të procedurës plotëson kushtet procedurale për miratimin e saj, dhe jo për "të drejtat dhe detyrimet civile" të parashtruesit të kërkesës në kuptim të së drejtës për gjykim të drejtë nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së. Përveç kësaj, Gjykata iu referua praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, e cila përcakton se neni 6 i KEDNj-së nuk është i zbatueshëm në procedurat për përsëritjen e ndonjë rasti, sepse një person, dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij, nuk është "i akuzuar për ndonjë vepër penale" në kuptim të nenit 6 (shih: rastin e GjEDNj-së, *Franz Fischer kundër Austrisë*, nr. 27569/02, vendimi, i 6 majit 2003).

Gjykata konkludoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me procedurën gjyqësore të zhvilluar nga gjykatat, sipas kërkesës së tij për rishikimin e procedurës, nuk janë *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimit të dytë të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, Gjykata pas analizës konkludoi se pretendimet e tij ishin të pabazuara pasi që ai kishte në dispozicion mjete juridike por ai nuk i shfrytëzoi si të tilla për të realizuar të drejtat e tij, dhe kësisoj, Gjykata ato pretendime i shpalli (ii) si pretendime me "mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes", siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI63/21

Parashtrues

Hysen Metahysa

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Njoftimit të Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Istog GJ.A. nr. 29/21 të 3 shkurtit 2021, në lidhje me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml. nr. 112/2015 të 22 qershorit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Hysen Metahysa nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesin e kërkesës e përfaqësojnë Skender Musa dhe Leonora Dervishaj– Pacolli, avokatë nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Njoftimin e Gjykatës Themelore në Pejë –dega në Istog GJ.A. nr. 29/21 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), e 3 shkurtit 2021, në lidhje me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml. nr. 112/2015, të 22 qershorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Gjykatës Themelore GJ.A. nr. 29/21 në lidhje me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit, pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 mars 2021, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 prill 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Bajram Ljatifi (anëtarë).

7. Më 12 prill 2021, Gjykata njoftoi përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe në të njëjtën kohë u kërkoi atyre që të dorëzojnë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim të parashtruesit të kërkesës. Përfaqësuesit e dorëzuan autorizimin në Gjykatë brenda afatit.

8. Më 22 prill 2021, Gjykata u dërgoi një shkresë shtesë përfaqësuesve të parashtruesit të kërkesës, duke kërkuar dokumente shtesë.

9. Më 27 prill 2021, Gjykata pranoi dokumente shtesë nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës.

10. Më 28 prill 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore në Pejë për regjistrimin e kërkesës, dhe të njëjtën kohë kërkoi nga gjykata që të paraqesë dëshmi në Gjykatë se kur Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pml. nr. 112/2015, i 22 qershorit 2015, u ishte dorëzuar përfaqësuesve të parashtruesit apo parashtruesit të kërkesës.

11. Më 6 maj 2021, Gjykata Themelore në Pejë përmes postës elektronike njoftoi Gjykatën se rasti i parashtruesit të kërkesës është në Gjykatën Themelore në Istog, dhe që t'u drejtohet atyre në lidhje me dëshminë për dorëzimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

12. Më 12 maj 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore në Istog duke kërkuar që ajo të dorëzojë dëshmi se kur aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pml. nr. 112/2015, i 22 qershorit 2015, u ishte dorëzuar përfaqësuesve të parashtruesit të kërkesës, apo parashtruesit të kërkesës.

13. Më 17 maj 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë shtesë përfaqësuesve të parashtruesit të kërkesës përmes së cilës kërkoi që të dorëzojnë në Gjykatë vendimin e Gjykatës Komunale nr. 159/15 të 5 gushtit 2015, si dhe të japin shpjegime shtesë në lidhje me një pjesë të procedurës gjyqësore, duke u dhënë atyre një afat prej 7 ditësh për ta bërë këtë. Gjykata konstaton se përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës nuk dhanë asnjë përgjigje përkundër faktit se ata e pranuan shkresën nga Gjykata më 19 maj 2021, të cilën gjë Gjykata e konstatoi në bazë të fletëkthesës për dorëzimin e shkresës.

14. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.

15. Më 25 maj 2021, Gjykata Themelore në Istog dërgoi dëshmitë e kërkuara për dorëzimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

16. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin Nr. KK160/21 caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani kryesuese në kolegjet shqyrtuese në rastet kur ajo është caktuar anëtare e kolegjit, përfshirë rastin e tanishëm.

17. Më 3 qershor 2021, Gjykata u dërgoi një shkresë shtesë përfaqësuesve të parashtruesit të kërkesës që të dorëzojnë përgjigje ndaj shkresës së dërguar atyre nga Gjykata më 17 maj 2021. Bazuar në fletëkthesë, Gjykata konkludon se përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës e kanë pranuar shkresën e Gjykatës së 3 qershorit 2021, më 7 qershor 2021, por përsëri nuk kanë dërguar asnjë përgjigje brenda afatit të caktuar.

18. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës nr. KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

19. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani nxori vendimin Nr. K.SH. KI63/21, duke zëvendësuar kryesuesen e mëparshme të Kolegjit shqyrtues Arta Rama-Hajrizi, në rolin e saj me gjyqtaren Gresa Caka Nimani.

20. Më 7 tetor 2021, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

21. Në bazë të shkresave të lëndës në rastin konkret, Gjykata konstaton se thelbi i kontestit në gjykatat e rregullta kishte të bënte me procedurën penale të zhvilluar lidhur me veprën penale të "*marrjes së ryshfetit sipas nenit 343 (2) në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK)",* e cila pretendohet të jetë kryer nga parashtruesi i kërkesës dhe personi I.G, si pjesëtarë të Shërbimit Policor të Kosovës.

22. Në lidhje me këtë u zhvilluan tri procedura gjyqësore, nga të cilat: procedura e parë gjyqësore kishte të bënte me procedurën penale në të cilën ishte përcaktuar përgjegjësia penale e parashtruesit të kërkesës dhe personit I.G., procedura e dytë gjyqësore kishte të bënte me procedurën penale kundër personit M.M., pronarit të kamionit i cili pretendohet se i kishte dhënë ryshfet personit I.G., bashkëkryerësit të pretenduar të parashtruesit të kërkesës në kryerjen e veprës penale, ndërsa procedura e tretë gjyqësore kishte të bënte me kërkesën e

parashtruesit për rishikimin e procedurës penale në të cilën ai dhe personi I.G. ishin dënuar.

23. Në lidhje me procedurën e dytë gjyqësore, Gjykata duhet të theksojë një fakt tjetër të rëndësishëm, përkatësisht se parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore nr. 497/13 në lidhje me procedurën penale në të cilën ai nuk paraqitet si palë e drejtpërdrejtë në procedurë, por vetë rezultati i asaj procedure penale kishte implikime të drejtpërdrejta në procedurën e tretë gjyqësore të iniciuar nga parashtruesi me kërkesën për rishikim të procedurës penale. Kjo është procedura penale kundër personit M.M., pronarit të kamionit që pretendohet se i kishte dhënë ryshfet personit I.G., bashkëkryerësit të pretenduar të parashtruesit të kërkesës në kryerjen e veprës penale, e cila gjithashtu do të paraqitet veçmas në kuadër të përmbledhjes së fakteve.

24. Duke pasur parasysh të gjitha këto fakte, Gjykata duhet të paraqesë të gjitha procedurat e përmendura gjyqësore individualisht në tekstin e këtij aktvendimi, me qëllim të përcaktimit të të gjitha rrethanave të rastit konkret.

Procedura e parë gjyqësore në lidhje me përcaktimin e përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës dhe personit I.G.

25. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës dhe personi I.G., si pjesëtarë të Shërbimit Policor të Kosovës, më 7 maj 2008 ndaluan kamionin me dy persona në të, dhe me atë rast, pretendohet se ata kërkuan dhe më pas morën dhurata nga pronari i kamionit M.M.

26. Më 25 qershor 2008, Prokuroria Publike Komunale në Pejë parashtroi në Gjykatën Themelore në Istog propozim akuzën PP. nr. 888/08, kundër parashtruesit të kërkesës dhe personit I.G., nën dyshimin e bazuar se ata kishin kryer veprën penale si bashkëkryerës, "*marrjes së ryshfetit sipas nenit 343 (2) në lidhje me nenin 23 të KPK-së*".

27. Gjatë shqyrtimit kryesor në Gjykatën Themelore, u paraqit si dëshmitar edhe pronari i kamionit M.M., me ç'rast përsëriti deklaratën e tij të mëparshme, duke theksuar, "*se ai u dha të pandehurve shumën prej 50 euro për të mos shkruar gjobën për kundërvajtje të cilën e kishte kryer shoferi i kamionit*".

28. Më 26 janar 2009, Gjykata Komunale në Istog nxori Aktgjykimin P. nr. 284/08 duke shpallur parashtruesin e kërkesës dhe personin I.G.

fajtor për veprën penale të "*marrjes së ryshfetit sipas nenit 343 (2) në lidhje me nenin 23 të KPK-së*", dhe u dënuan me 3 muaj burgim.

29. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

30. Më 1 tetor 2009, Gjykata e Qarkut nxori Aktvendimin AP. nr. 29/09, përmes të cilit aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore P. nr. 284/08, dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim dhe rigjykim. Në arsyetimin e aktvendimit, Gjykata e Qarkut theksoi:

> *"Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par, 1 nënpar. 12 të KPPK-së, për faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm. Në dispozitivin e aktgjykimit thuhet se të pandehurit [...] janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par. 2 e lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe janë gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga 3 tre muaj, për secilin, duke mos i përcaktuar të pandehurit secilin veq e veq, veprën penale si dhe dënimin e shqiptuar, e në këtë mënyrë duke mos vepruar në kuptim të nenit 391 par.1 nene par.3 të KPK-së. Nga këto arsye u deshtë që aktgjykimi i atakuar të prishet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje".*

31. Më 27 maj 2010, në procedurën e përsëritur, Gjykata Komunale nxori Aktgjykimin P. nr. 14/10, në të cilën shpalli parashtruesin e kërkesës dhe personin I.G. fajtorë për *marrje të ryshfetit sipas nenit 343 (2) në lidhje me nenin 23 të KPK-së*, dhe i dënoi ata me 90 ditë burgim, si dhe një gjobë prej 20 eurosh. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata Themelore deklaroi: "*[...] Në bazë të këtyre provave të procedurës e të vlerësuar gjykata ka qetur qe në veprimet e të të akuzuarve qëndrojnë elemente të veprës penale, marrje të ryshfetit nga neni 343/2 lidhur me nenin 23 te KPK, pra të veprës penale në bashkëveprim, ngase me provat e lartcekura në mënyrë të pa dyshimt është vërtetuar gjendja faktike ashtu siq është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimit, për çka dhe për të cilën vepër penale, gjykata të pandehurit i shpall penalisht përgjegjëse pasi që nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin me përjashtuar përgjegjsin e tyre penale*".

32. Nga shkresat e lëndës Gjykata konstaton se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale P. nr. 14/10, i 27 majit 2010, u bë i plotfuqishëm më 15 shtator 2011.

Procedura e dytë gjyqësore, përkatësisht procedura penale kundër personit M.M., pronarit të kamionit që pretendohet se i kishte dhënë ryshfet personit I.G., bashkëkryerësit të pretenduar të parashtruesit të kërkesës në kryerjen e veprës penale

33. Më 6 nëntor 2013, Prokuroria Publike Komunale në Pejë, ngriti propozim akuzën PP-nr. 1181/2012, në Gjykatën Themelore në Pejë - dega në Istog (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), kundër personit M.M., për veprën penale, "*deklarim i rremë nga neni 307 paragrafi 1 të KPK-së*".

34. Më konkretisht, Prokuroria Publike Komunale ngriti aktakuzë kundër personit M.M., pronarit të kamionit, në bazë të kallëzimeve në polici dhe më pas deklaratave gjatë gjykimit, parashtruesi i kërkesës dhe personi I.G., u shpallën fajtorë për kryerjen e veprës penale marrja e ryshfetit sipas nenit 343 paragrafi 2 në lidhje me nenin 23 të KPK-së, dhe u dënuan me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale P. nr. 14/10, të 27 majit 2010.

35. Më 4 qershor 2014, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin P. nr. 497/13, përmes të cilit e shpalli të akuzuarin M.M. fajtor për veprën penale "*deklarim i rremë nga neni 307 paragrafi 1 të KPK-së*", dhe e dënoi atë me kusht.

36. Në arsyetimin e aktgjykimit P. nr. 497/13, të Gjykatës Themelore thuhet:

> *"[...] Gjatë shqyrtimit kryesor fillestar i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësin. Në bazë të provave të nxjerrura gjatë shqyrtimit kryesor, fakteve dhe rrethanave të pakontestuara ku i pandehuri nuk e ka kontestuar dhe e ka pranuar fajësin, me faktin se ditën kritike me datën 07.06.2012, në Gjykatën Komunale në Klinë, në procedurën administrative ka dhënë deklaratë të rreme, në atë mënyrë që me datë të lartshënuar e jep një deklaratë me shkrim me të cilën e revokon deklaratën e tij të dhënë në seancë gjyqsore, duke qenë në dijeni se me këtë deklaratë po deklaron të pavërteta në lidhje me faktet që janë provuar dhe në bazë të cilave janë shpallë fajtor Islam Gërvalla dhe Hysen Metahysa, me Aktgjykimin me P. nr. 284/08, për*

vepër penale marrja e ryshfetit, me qka ka kryer vepër penale, deklarimi i rremë nga neni 307 par. 1, të KPK-së ...".

Procedura e tretë gjyqësore e parashtruesit të kërkesës në lidhje me kërkesën për rishqyrtim të procedurës penale, pas aktgjykimit dënues të Gjykatës Themelore, P. nr. 497/13, përmes së cilit personi M.M. u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale "*deklarim i rremë nga neni 307 paragrafi 1 i KPK-së*"

37. Në një ditë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Themelore kërkesë për rishqyrtim të procedurës penale, duke deklaruar si provë kryesore të bazueshmërisë së kërkesës së tij faktin se personi M.M. në një proces tjetër gjyqësor ishte shpallur fajtor për veprën penale "*deklarim i rremë nga neni 307 paragrafi 1 i KPK-së*", në procedurën penale kundër tij dhe personit I.G., me ç'rast edhe janë dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Komunale P. nr. 14/10, të 27 majit 2010.

38. Më 27 janar 2015, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin P. nr. 342/2014, përmes të cilit refuzoi kërkesën e parashtruesit për përsëritje të procedurës si të pabazuar, duke deklaruar se: „*Gjykata, pasi vlerësoi kërkesën për përsëritje të procedurës në pajtim me dispozitat e nenit 423 të KPPK-së, konstatoi se në këtë rast nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për përsëritjen e procedurës penale kundër të dënuarit Hysen (Mazllum) Metahysaj, për shkak të faktit se i dënuari nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi shtesë për të vërtetuar një situatë tjetër faktike të vërtetuar me aktgjykimin në fjalë".*

39. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore P. nr. 342/2014, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata e Apelit të ndryshojë aktvendimin e ankimuar, duke lejuar përsëritjen e procedurës penale.

40. Më 27 mars 2015, Prokurori i Apelit, me parashtresën PPN/II. nr. 67/2015, propozoi që ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër aktvendimit të ankimuar të refuzohet si e pabazuar.

41. Më 1 prill 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin PN. nr. 131/2015, duke refuzuar ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e aktvendimit, Gjykata e Apelit theksoi:

"Sipas mendimit të kësaj gjykate, pretendimet ankimore nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë refuzoi kërkesën për përsëritjen e procedurës penale për të dënuarin e lartpërmendur me arsyetimin se në këtë rast kushtet ligjore për përsëritjen e procedurës penale kundër të dënuarit, Hysen (Mazllum) Metahysaj, nuk ishin plotësuar për shkak të faktit se i dënuari nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi shtesë që do të vërtetonte gjendjen faktike ndryshe të vërtetuar me aktgjykimin e plotfuqishëm në këtë rast. Prandaj, bazuar në këtë kusht të vendosur të gjykatës së shkallës së parë, ky kolegj vlerësoi aktvendimin e ankimuar në lidhje me pretendimet ankimore dhe konstaton se pretendimet ankimore të të dënuarit me aktgjykim të formës së prerë nuk qëndrojnë, sepse të njëjtit me kërkesën për përsëritje të procedurës penale të dërguar në gjykatën e shkallës së parë, dhe as me ankesën e drejtuar në këtë gjykatë, nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi konkrete në pajtim me nenin 423 paragrafi 1 të KPPK-së, dhe të cilat do të ishin prova të mjaftueshme për gjykatën që të ketë një bazë ligjore për përsëritje të procedurës penale, e cila në këtë rast përfundoi me aktgjykim të formës së prerë....".

42. Parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN. nr. 131/2015 të 1 prillit 2015 dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore PK. nr. 342/2014, të 27 janarit 2015.

43. Më 22 qershor 2015, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Pml. nr. 112/2015, përmes të cilit aprovoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit, duke anuluar vendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe duke e kthyer rastin në Gjykatën Themelore për rishqyrtim.

44. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata Supreme theksoi:

"Në bazë të dispozitës së nenit 423, paragrafi 1, pika 1 e KPPK, procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet nëse provohet se aktgjykimi është mbështetur në dokument të falsifikuar ose në deklarim të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit.

Andaj, arsyet e dhëna në aktvendimin e shkallës së parë dhe të dytë janë plotësisht të paqarta dhe për faktin vendimtar, pra, për ekzistimin e provës së (aktgjykimit të lartcekur) e cila mund të jetë bazë për rishikimin e procedurës penale, ekziston

kundërthënie në mes të asaj çka ceket në arsyetimin e aktvendimeve të atakuara dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës. Kjo paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 12 të KPPK dhe për pasojë ka anulimin e këtyre aktvendimeve.

Në rishqyrtim, gjykata e shkallës së parë duhet të merrë parasysh aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Pejë – dega në Klinë P. nr. 497/2013 të datës 04.06.2014, atë të vlerësojë në mënyrë ligjore dhe të merr vendim për bazueshmërinë e kërkesës për rishikimin e procedurës penale. Pra, ky aktgjykim nuk mund të anashkalohet, pa marrë parasysh se çfarë është përmbajtja e tij – a është fjala për një aktgjykim i cili me të vërtetë tregon për nevojën e rishikimit të procedurës apo jo. Me rastin e vlerësimit të tij duhet të kihet parasysh se për çka është shpallur fajtor Muhamet Meta – për deklarimin e rremë gjatë procedurës penale e që ka ndikuar në shpalljen fajtor të dënuarve Hysen Metahysa dhe Islam Gërvalla, apo jashtë kësaj procedure".

45. Duke vepruar sipas rekomandimit të Gjykatës Supreme, në procedurën e përsëritur, Gjykata Themelore vlerësoi të gjitha provat me qëllim të përcaktimit të bazueshmërisë së kërkesës për përsëritje të procedurës, duke përfshirë aktgjykimin e Gjykatës Themelore P. nr. 497/2013, të 4 qershorit 2014. Prandaj, më 5 gusht 2015, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin PK. nr. 159/15, përmes të cilit refuzoi kërkesën për përsëritjen e procedurës së parashtruesit si të pabazuar, duke theksuar:

"*Gjykata, pasi vlerësoi kërkesën për përsëritje të procedurës në pajtim me dispozitat e nenit 423 të KPPK-së, konstatoi se në këtë rast nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për shqyrtimin e procedurës penale kundër të dënuarit Hysen (Mazllum) Metahysaj, për faktin se gjykata, duke marrë si bazë provat të paraqitura nga personi i dënuar në kërkesë, në bazë të të cilave ai u shpall fajtor, siç është deklarata e palës së dëmtuar në cilësinë e dëshmitarit Muhamet Mehaj, dhënë në seancën gjyqësore më 24.12.2008, në Gjykatën Komunale në Istog, nga ky kolegj u vlerësua si i vërtetë, me vetë faktin që dëshmitari në deklaratën e dytë të dhënë në procedurën administrative më 07.06.2012. ndryshoi deklaratën e mëparshme me arsyetimin se deklarata e dhënë gjatë seancës gjyqësore në Gjykatën Komunale në Istog më 24.12.2008. nuk ishte e vërtetë dhe se i njëjti për deklaratën e 07.06.2012 është akuzuar dhe dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - Dega në Klinë, P. nr. 497/13, të datës 04.06.2014, me*

dënim me kusht për veprën penale të dëshmisë së rreme, sipas nenit 307, paragrafi 1 të KPPK-së. Prandaj, gjykata, duke marrë parasysh sa më sipër, konstatoi se deklarata e dytë e dëshmitarit, e dhënë më 07.06.2014, është deklaratë e rreme, jo deklarata e dhënë më 24.12.2008, dhënë para Gjykatës Komunale në Istog, duke marrë parasysh sa më sipër, nuk gjeti asnjë arsye për të vërtetuar ndonjë situatë tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar me aktgjykimin në fjalë".

46. Përmes të njëjtit aktvendim, Gjykata Themelore në udhëzimin për mjetin juridik ka theksuar që "*pala ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit brenda 3 ditëve*".

47. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës nuk parashtroi ankesë, brenda tri ditëve, siç është cekur në aktvendimin PK. nr. 159/15, të Gjykatës Themelore, në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të Themelore të 5 gushtit 2015.

48. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës i dërgoi Gjykatës Themelore kërkesë për caktimin e shqyrtimit kryesor në çështjen e tij penale, duke konsideruar se Gjykata Themelore duhet të caktojë një seancë shqyrtuese në bazë të aktgjykimit Pml. nr. 112/2015, të Gjykatës Supreme.

49. Më 22 tetor 2020, Gjykata Themelore i dërgoi Njoftimin PK. nr. 342/2014, parashtruesit të kërkesës duke e njoftuar atë se "*[...] Gjykata Themelore në Pejë me Aktvendimin PK. nr. 342/14, të datës 27.01.2015 e ka refuzuar kërkesën për rishikimin e procedurës penale të gjykuarit Hysen Metahysa, i gjykuar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Istog P. nr. 14/10, të datës 27.05.2010 i formës së prerë me datë 15.09.2011, si e pa bazuar*".

50. Më 5 janar 2021 dhe 8 janar 2021, parashtruesi i kërkesës i dërgoi dy kërkesa në Gjykatën Themelore për të caktuar shqyrtimin gjyqësor, në procedurën e tij penale.

51. Më 3 shkurt 2021, Gjykata Themelore i dërgoi parashtruesit Njoftimin GJ.A. nr. 29/21, duke deklaruar, ndër të tjera:

"Me Aktgjykimin Pml. nr. 112/2015, të 22 qershorit 2015, Gjykata Supreme miratoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari Hysen Metahysa, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë PK. nr. 342/2014, të 27.01.2015, përmes të cilit refuzoi kërkesën për përsëritjen e procedurës dhe

Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PN. nr. 13/2015 të 01.04.2015, përmes të cilit vërtetohet aktvendimi i shkallës së parë, të njëjtat aktvendime u anuluan nga Gjykata Supreme dhe u kthyen për rishqyrtim në shkallën e parë me këshillën që gjykata e shkallës së parë në rishqyrtim të marrë parasysh aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Klinë P. nr. 497/2013, të 04.06.2014, në të cilin aktgjykim i dënuari mbështeti kërkesën për rishqyrtimin e procedurës penale (për ta vlerësuar atë si provë dhe jo për të arritur në përfundimin se nuk ka paraqitur prova).

Prandaj, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Pml. nr. 112/2015 të 22.06.2015. nuk urdhëroi caktimin e shqyrtimit kryesor, por e ktheu çështjen në rigjykim për të vendosur përsëri mbi kërkesën e të akuzuarit për përsëritje të procedurës, me arsyet e mësipërme në aktgjykim.

Gjykata Themelore në Pejë, me Aktvendimin PK. nr. 159/15 të 05.08.2015, duke vepruar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 122/15, të 22.06.2015, në rastin e rigjykimit, sipas kërkesës për rishqyrtim të procedurës penale të përfunduar me aktgjykimin e plotfuqishëm të ish -Gjykatës Komunale në Istog P. nr. 14/10, të 27.05.2010 refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të procedurës penale të paraqitur nga i pandehuri Hysen (Mazllum) Metahys. Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën e të pandehurit për përsëritje të procedurës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, konstatoi se kërkesa është e pabazuar dhe nuk gjeti asnjë arsye për të dëshmuar një situatë tjetër faktike të vërtetuar me aktgjykimin e rastit.

Kundër Aktvendimit të fundit të Gjykatës Themelore në Pejë, PK. nr. 159/15, të 05.08.2015, pala u udhëzua që ka të drejtë ankese brenda tre (3) ditëve, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Aktvendimi PK. nr. 159/15 i 05.08.2015, i pandehuri Hysen Metahysa pranoi personalisht dhe kundër këtij vendimi nuk u paraqit ankesë.

Prandaj, nga të lartcekurat del se procedura penale kundër tani të akuzuarit Hysen Metahysa është çështje e gjykuar (res judicata) dhe nuk ka asnjë arsye në këtë gjykatë për të caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

52. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Njoftimit të Gjykatës Themelore, janë shkelur dispozitat e nenit 31 dhe nenit 32 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të KEDNJ -së.

53. Më konkretisht, parashtruesi pretendon "*që e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e cila iu garantohet të gjithë qytetareve pa dallim në procedurë para gjykatave dhe organeve tjera shtetërore si dhe paragrafi 2 i kësaj dispozite garanton që çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik, të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngritët kundër saj/tij, në një afat të arsyeshëm nga një gjykatë të pavarur*".

54. Parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, gjithashtu shton se "*në dispozitivin e aktgjykimit Pml. nr. 112/2015, ku janë anuluar vendimet e Gjykatës Themelore në Pejë PK. nr. 342/2014 dhe vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Pn. nr. 131.2015 i datës 01.04.2015 dhe çështja i kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë, prandaj konfrom këtij aktgjykimi gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar që të caktojë seancë dhe të sigurojë gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe jo të vendosë për të ashtuquajturën kërkesë për përsëritje të procedurës sepse gjykata më e lartë ka anuluar vendimet e gjykatave më të ulëta, prandaj sipas detyrës zyrtare gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar që të caktojë seancë dhe të procedojë sipas aktakuzës. Me këto veprime Gjykata Themelore në Pejë ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës nenin 31 dhe me këtë ka shkelur të drejtën e të mbrojturit tonë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejtë kjo që bënë pjesë në të drejtat themelore të njeriut*".

55. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Themelore, duke mos caktuar seancën gjyqësore "*ka vepruar në kundërshtim me nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale e cila dispozitë zbatohet lidhur me nenin 407, par. 2 të këtij Kodi dhe në pajtim me par. 3 të nenit 406 të KPPRK-së ka qenë e obliguar që ti marrë të gjitha veprimet procedurale dhe të shqyrton të gjitha çështjet të theksuara në vendimin e Gjykatës Supreme. Në pajtim me par. 1 të nenin 406 Gjykata Themelore në Pejë ka qenë e obliguar që lëndën e dërguar për gjykim nga Gjykata Supreme e Kosovës ta procedoj në bazë të aktakuzës së mëparshme sepse vendimi i saj dhe vendimi i Gjykatës së Apelit janë anuluar në tërësi*"

56. Sa i përket shkeljes së nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon "*se është shkelur neni 31 i Kushtetutës, ku garantohet e drejta për mjete juridike dhe në këtë rast pala ka shfrytëzuar të drejtat për mjetet e ankimit të jashtëzakonshme, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të dorëzuar në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila e ka aprovuar këtë kërkesë dhe e ka obliguar gjykatën e shkallës së parë që çështjen ta vendosë në rigjykim dhe jo të vendos jashtë seance dhe të refuzoj zbatimin e vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës*".

57. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ajo ta obligojë "*Gjykatën Themelore në Pejë të zbatoj nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ashtu që të sigurohet gjykim të drejtë dhe të paanshëm duke zbatuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe duke caktuar seancë gjyqësore dhe të shqyrtojë shkeljet esenciale të procedurës penale, shkeljen e ligjit penal dhe vërtetimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*"

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

58. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

59. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
> *[...]*

60. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat tjera të pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

61. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe se ka specifikuar aktin e autoritetit publik, kushtetutshmërinë e të cilit ai po e konteston në Gjykatë.

62. Gjykata merr parasysh edhe nenin 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor

[...]."

63. Sa i përket përmbushjes së kushteve tjera, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston aktin e një autoriteti publik, përkatësisht Njoftimin e Gjykatës Themelore në Pejë – dega në Istog GJ.A. nr. 29/21 të 3 shkurtit 2021 në lidhje me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml. nr. 112/2015 të 22 qershorit 2015, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe i ka dorëzuar kërkesat në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

64. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 (2) dhe (3) (b) të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

> *"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."*
>
> *(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:*
>
> *[...]*
>
> *(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;*
>
> *[...]."*

65. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

66. Gjykata gjithashtu shton se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'u referohet të njëjtave si "pretendime qartazi të pabazuara". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "*të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*". (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkese të vlerësuar si "*qartazi të pabazuar*", dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si "*qartazi të pabazuara*", Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e

Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284).

67. Prandaj, Gjykata konstaton, në bazë të fakteve të shkresave të lëndës si dhe pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, se parashtruesi i kërkesës në thelb ka dy pretendime kryesore, të cilat ai i sjell ekskluzivisht në lidhje me kërkesën e tij për rishqyrtimin e procedurës penale. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se me mosaprovimin e kërkesës së tij për përsëritjen e procedurës penale janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

68. Prandaj, Gjykata në vazhdim të raportit do të trajtojë veçmas këto pretendime të parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

69. Sa i përket shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ -së, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës përmend si argument kryesor të shkeljes së pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së faktin se "*Gjykata Supreme me aktgjykim ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë PK. nr. 342/2014 dhe aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Pn. nr. 131.2015 i datës 01.04.2015 dhe çështja i kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë, prandaj konfrom këtij aktgjykimi gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar që të caktojë seancë dhe të sigurojë gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe jo të vendosë për të ashtuquajturën kërkesë për përsëritje të procedurës sepse gjykata më e lartë ka anuluar vendimet e gjykatave më të ulëta, prandaj sipas detyrës zyrtare gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar që të caktojë seancë dhe të procedojë sipas aktakuzës*".

70. Gjykata, pikërisht duke pasur parasysh këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës në kontekstin e garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, konstaton se procedura gjyqësore e përmendur në të cilën parashtruesi i kërkesës i bazon pretendimet e tij ankimore kishte të bënte vetëm me vlerësimin e përmbushjes së kërkesave procedurale të cilat duhet t'i përmbushë një kërkesë për përsëritje të procedurës, në mënyrë që të jetë e pranueshme, dhe kështu rasti do të rihapej për shqyrtim dhe vlerësim në procedurën e përsëritur.

71. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se në rastin konkret Gjykata Themelore ka vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme e cila urdhëroi Gjykatën Themelore që të shqyrtojë të gjitha provat dhe argumentet në lidhje me vlerësimin procedural të përmbushjes së kushteve për rihapjen e procedurës, dhe kështu ta bëjë vlerësimin e tyre, me theks të veçantë në vlerësimin e aktgjykimit P. nr. 497/13 të Gjykatës Themelore, që sipas gjetjeve të kësaj gjykate, Gjykata Themelore e ka bërë.

72. Gjykata dëshiron të sqarojë se gjykatat e rregullta në procedurën sipas kërkesës për përsëritje të procedurës vendosin vetëm lidhur me çështjen nëse kërkesa për përsëritje të procedurës plotëson kushtet procedurale për miratimin e saj, dhe jo për "*të drejtat dhe detyrimet civile*" të parashtruesit të kërkesës brenda kuptimit të së drejtës për gjykim të drejtë të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

73. Përveç kësaj, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila përcakton se neni 6 i KEDNJ-së nuk është i zbatueshëm në procedurat për përsëritjen e ndonjë rasti, sepse nëse një person dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij dhe ai ose ajo gjatë kësaj procedure nuk është "i akuzuar për ndonjë vepër penale" në kuptim të nenit 6 të Konventës (shih rastin e GJEDNj-së, *Franz Fischer kundër Austrisë,* nr. 27569/02, të 6 majit 2003).

74. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson arsyetimin juridik të GjEDNj-së në rastin e përmendur *Franz Fischer kundër Austrisë* lidhur me ankesën e tij përkitazi me mosrihapjen e procedurës gjyqësore, me ç'rast GjEDNj ka konstatuar:

> *"Parashtruesi i kërkesës u ankua se procedura lidhur me kërkesën e tij për rigjykim pas aktgjykimit të Gjykatës Franz Fischer kundër Austrisë të 29 majit 2001 nuk i ka plotësuar kërkesat e nenit 6, i cili, në pjesën relevante, thotë:*
>
> *"Në përcaktimin e ... të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht ... nga një gjykatë ...".*
>
> *Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse neni 6 aplikohet në procedurën në fjalë. Lidhur me këtë, Gjykata përsërit se sipas praktikës gjyqësore të vendosur neni 6 nuk aplikohet në procedurat për ripërtëritje të procedurës penale, duke marrë*

parasysh se dikush që paraqet kërkesë për rihapjen e lëndës dhe dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm nuk është i akuzuar për vepër penale në kuptim të nenit në fjalë (shih Dankevich kundër Ukrainës (vendim), nr. 40679/98, i 25 majit 1999, Sonnleitner kundër Austrisë (vendim), nr. 34813/97, i 6 janarit 2000; dhe Kucera kundër Austrisë (vendim), nr. 40072/98, i 20 marsit 2001, secili me referenca të mëtejmë).

Ngjashëm, është përcaktuar që neni 6 nuk aplikohet në procedurat për njohjen e pavlefshmërisë me qëllim të ruajtjes së ligjit, të iniciuara me qëllim që të anulohet aktgjykimi dënues i plotfuqishëm pasi që Gjykata ka konstatuar shkelje, sepse në atë procedurë personi në fjalë nuk është "i akuzuar për vepër penale" (Oberschlick kundër Austrisë, nr. 19255/92 dhe 21655/93, Vendimi i Komisionit i 16 majit 1995, Vendime dhe Raporte 81, faqe 5).

Gjykata konsideron se procedurat sipas nenit 363 a të Kodit Austriak të Procedurës Penale, që kanë të bëjnë me kërkesën për përsëritjen e procedurës pasi që Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konstatuar shkelje, janë të ngjashme me procedurën për ripërtëritjen e procedurës penale. I paraqet personi aktgjykimi dënues i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe nuk ka të bëjë me "përcaktimin e akuzës penale", por me çështje nëse janë plotësuar kushtet për miratimin e rigjykimit. Gjykata së këndejmi konkludon se neni 6 nuk aplikohet në procedurën në fjalë".

75. Gjykata, duke ndërlidhur pretendimet të parashtruesit të kërkesës me praktikën e GjEDNj-së, vëren se në rastin konkret parashtruesit nuk iu miratua kërkesa për përsëritjen e procedurës penale me arsyetim të qartë të Gjykatës Themelore, e cila, duke vepruar sipas rekomandimit të Gjykatës Supreme, në procedurën e përsëritur, refuzoi si të pabazuar kërkesën për rihapjen e procedurës, duke theksuar:

"*Gjykata, pasi vlerësoi kërkesën për përsëritje të procedurës në pajtim me dispozitat e nenit 423 të KPPK-së, konstatoi se në këtë rast nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për shqyrtimin e procedurës penale kundër të dënuarit Hysen (Mazllum) Metahysaj, për faktin se gjykata, duke marrë si bazë provat të paraqitura nga personi i dënuar në kërkesë, në bazë të të cilave ai u shpall fajtor, siç është deklarata e palës së dëmtuar në cilësinë e dëshmitarit M.M., dhënë në seancën gjyqësore më 24.12.2008, në Gjykatën Komunale në Istog, nga ky kolegj u vlerësua si i vërtetë, me vetë faktin që dëshmitari në deklaratën e dytë të dhënë*

në procedurën administrative më 07.06.2012. ndryshoi deklaratën e mëparshme me arsyetimin se deklarata e dhënë gjatë seancës gjyqësore në Gjykatën Komunale në Istog më 24.12.2008. nuk ishte e vërtetë dhe se i njëjti për deklaratën e 07.06.2012 është akuzuar dhe dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - Dega në Klinë, P. nr. 497/13, të datës 04.06.2014, me dënim me kusht për veprën penale të dëshmisë së rreme, sipas nenit 307, paragrafi 1 të KPPK-së. Prandaj, gjykata, duke marrë parasysh sa më sipër, konstatoi se deklarata e dytë e dëshmitarit, e dhënë më 07.06.2014, është deklaratë e rreme, jo deklarata e dhënë më 24.12.2008, dhënë para Gjykatës Komunale në Istog, duke marrë parasysh sa më sipër, nuk gjeti asnjë arsye për të vërtetuar ndonjë situatë tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar me aktgjykimin në fjalë".

76. Prandaj, Gjykata duke pasur parasysh përmbajtjen e procedurës gjyqësore në të cilat parashtruesi i ka mbështetur pretendimet e tij ankimore për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën e vet gjyqësore, sipas së cilës neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për rishikimin ose përsëritjen e procedurës (shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI07/17/15, *Pashk Mirashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 qershorit 2017, paragrafi 64; KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31; shih, gjithashtu rastet e GJEDNJ-së, *inter alia, Oberschlick kundër Austrisë*, nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 1994, *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2011).

77. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me procedurën gjyqësore të zhvilluar nga gjykatat sipas kërkesës së tij për rishikimin e procedurës nuk janë *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës

78. Sa i përket shkeljes së nenit 32 të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu konstaton se këto pretendime parashtruesi i kërkesës i vë ekskluzivisht në lidhje me kërkesën e tij për përsëritjen e procedurës gjyqësore, duke marrë parasysh se ai si palë, me aktgjykimin e Gjykatës Supreme "*ka shfrytëzuar të drejtat për mjetet e ankimit të jashtëzakonshme, për*

faktin se Gjykata Supreme e ka obliguar gjykatën e shkallës së parë që çështjen ta vendosë në rigjykim dhe jo të vendo jashtë seance dhe të refuzoj zbatimin e vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës".

79. Duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet të vlerësojë nëse pretendimet e parashtruesit përmbajnë argumente juridike në lidhje me pretendimet e tij për shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës në kontekstin e procedurës gjyqësore që është zhvilluar në lidhje me kërkesën e tij për rishqyrtim të procedurës gjyqësore.

80. Megjithatë, para kësaj, Gjykata duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës me aktgjykimin konkret Pml. nr. 112/2015 të Gjykatës Supreme ka fituar, ose siç thotë ai në kërkesë "*ka shfrytëzuar të drejtat për mjetet e ankimit të jashtëzakonshme*" në procedurën e përsëritur gjyqësore në Gjykatën Themelore, dhe nëse ato ishin shfrytëzuar si të tilla nga parashtruesi i kërkesës.

81. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se me aktgjykimin Pml. nr. 112/2015 të Gjykatës Supreme për aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, procedura e parashtruesit të kërkesës ishte kthyer në Gjykatën Themelore, e cila ishte e obliguar të merrte parasysh të gjitha vërejtjet dhe të eliminonte të gjitha mangësitë në aktvendimet e evidentuara nga Gjykata Supreme, me referencë të veçantë në vlerësimin e aktgjykimit nr. 497/13, të Gjykatës Themelore, si dëshmi në të cilën parashtruesi i kërkesës e mbështeti kërkesën e tij për përsëritjen e procedurës.

82. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se duke miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe duke e kthyer çështjen në Gjykatën Themelore, Gjykata Supreme krijoi një situatë juridike e cila në vetvete përfshinte mundësitë procedurale të parashikuara me ligj dhe, kjo në vetvete, nënkupton të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve të caktuara juridike.

83. Gjykata vëren se në rrethanat e reja juridike të krijuara, Gjykata Themelore, duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme, më 5 gusht 2015, nxori një aktvendim të ri të PK. Nr. 159/15, duke konkluduar se nuk janë plotësuar të gjitha kushtet procedurale për miratimin e kërkesës për rihapjen e procedurës gjyqësore. Megjithatë, ajo që është e rëndësishme për këtë Gjykatë është fakti se Gjykata Themelore në Aktvendimin PK. nr. 159/15, parashikonte mundësinë e paraqitjes së një ankese në Gjykatën e Apelit kundër vendimeve të saj brenda 3 ditëve.

84. Gjykata veçanërisht thekson këtu faktin se një mjet i tillë juridik i krijuar në formën e një ankese, që parashihej nga Gjykata Themelore në aktvendimin PK. nr. 159/15, përbënte një mundësi që parashtruesi i kërkesës të vazhdonte rrugën e tij procedurale në Gjykatën e Apelit, ekskluzivisht për të kontestuar aktvendimin PK. nr. 159/15 të Gjykatës Themelore për mospërmbushjen procedurale të të gjitha kushteve për rihapjen e procedurës, dhe jo mjet juridik që për parashtruesin e kërkesës do të nënkuptonte edhe mundësinë e shfrytëzimit të tij me qëllim të kontestimit të përgjegjësisë penale pranë Gjykatës së Apelit, për arsye se në kërkesën për rihapjen e procedurës nuk vendoset për "*të drejtat dhe detyrimet*", dhe rrjedhimisht as për përgjegjësinë penale.

85. Megjithatë, Gjykata vëren se përkundër faktit se parashtruesi i kërkesës ishte në dijeni të aktvendimit PK. nr. 159/15 të Gjykatës Themelore, i cili edhe personalisht iu dorëzua atij, dhe që mund të konkludohet nga shkresat e lëndës, ai humbi mundësinë e vazhdimit të mundësisë procedurale për të provuar bazueshmërinë e kërkesës së tij për rihapjen e procedurës gjyqësore, me faktin se brenda afatit të caktuar nuk e kishte shfrytëzuar mjetin juridik në dispozicion në formën e një ankese.

86. Nga të lartcekurat, mund të konkludohet se parashtruesi kishte një mjet juridik në dispozicion të tij në atë kohë, por që ai nuk e shfrytëzoi atë mjet juridik në mënyrën dhe brenda afatit të parashikuar në udhëzimin për mjetin juridik të Gjykatës Themelore. Prandaj, duke mos e shfrytëzuar atë, parashtruesi i kërkesës hoqi dorë vullnetarisht nga rruga e mëtejshme procedurale në të cilën pretendimet e tij do të mund të shqyrtoheshin nga gjykatat më të larta.

87. Bazuar në të gjitha të lartcekurat, Gjykata përfundon se nuk ka asnjë argument ligjor në pretendimet e parashtruesit të kërkesës në mbështetje të pretendimeve të tij për shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës në kontekstin e mohimit të "*së drejtës për mjete të jashtëzakonshme juridike*" në aspektin procedural.

88. Gjykata rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastin e Gjykatës KI175/20, parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i

27 prillit 2021, paragrafi 81, shih, rastin e Gjykatës KI166/20, cituar më lart, paragrafi 51). Andaj, në lidhje me këto pretendime, Gjykata në përputhje me praktikën e saj e deklaron kërkesën e parashtruesit qartazi të pabazuar dhe rrjedhimisht të papranueshme.

89. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (ii) së pretendimeve me "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*", sepse parashtruesi i kërkesës kishte në dispozicion një mjet juridik i cili ishte paraparë në udhëzimin për mjetin juridik me aktvendimin PK. nr. 159/15 të Gjykatës Themelore dhe ky mjet juridik nuk ishte shfrytëzuar nga parashtruesi i kërkesës. Rrjedhimisht, këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

90. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, Gjykata i deklaron ato si (ii) pretendime me *"mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"*. Rrjedhimisht, të njëjtat, në tërësinë e tyre, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) dhe (3) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 tetor 2021, me shumicë votash,

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Radomir Laban Gresa Caka Nimani

KI110/20, Parashtrues i kërkesës: Et-hem Bokshi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Plm. nr. 76/2020, të 8 prillit 2020

KI110/20, aktvendim i 3 nëntorit 2021, publikuar më 26 nëntor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, parimi Ne bis in idem, E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës*

Rrethanat e rastit konkret kanë të bëjnë me procedurën penale të zhvilluar kundër parashtruesit të kërkesës në lidhje me shmangien e tatimit, përkatësisht mosparaqitje e qarkullimit faktik të realizuar në kuadër të aktiviteteve të subjektit afarist PKP "Marigona" i cili është në bashkëpronësi të parashtruesit të kërkesës. Në lidhje me këtë rast, fillimisht është iniciuar një procedurë administrative pranë ATK-së, e cila për shkak të mos paraqitjes së qarkullimit faktik të realizuar në kuadër të kryerjes së veprimtarive, e ka detyruar ta paguajë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat dhe ka gjobitur subjektin PKP "Marigona" në bashkëpronësi të parashtruesit të kërkesës, Pas kësaj, në lidhje me të njëjtën vepër, Prokuroria Themelore në Gjakovë ka ngritur aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës dhe partnerit të tij afarist, për veprën penale shmangie tatimore në bashkëkryerje. Kjo procedurë penale, e cila ishte objekt i kontrollit gjyqësor, ku së pari, Gjykata Themelore e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe partnerin e tij afarist për kryerjen e veprës penale, për çka i shqiptoi gjobë dhe dënim me burg me kusht. Në procedurën e apelit, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata Supreme gjithashtu hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke konstatuar se aktgjykimet e gjykatave më të ulëta ishin të drejta dhe të ligjshme.

Parashtruesi i kërkesës e konteston aktgjykimin e Gjykatës Supreme në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar *i.* shkeljen e të drejtës së garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me parimin *ne bis idem*; *ii.* shkeljen e të drejtës nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së në lidhje me parimin e *barazisë së armëve*; *iii.* shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me mënyrën e gabuar apo arbitrare të zbatimit të dispozitave ligjore dhe *iv.* shkeljen e të drejtave të garantuara nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Sa i përket shkeljes së pretenduar të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me parimin *ne bis in idem,* Gjykata konstatoi se këto pretendime kualifikohen si pretendime me "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"*;* dhe si të tilla, i deklaroi këto pretendime të parashtruesit të kërkesës si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39.

Sa i përket shkeljes së pretenduar të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me parimin e barazisë së armëve, Gjykata konstatoi se kjo pjesë e pretendimeve kualifikohen si pretendime *"të pambështetura apo të paarsyetuara"*; dhe si të tilla, i deklaroi këto pretendime të parashtruesit të kërkesës si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39.
Sa i përket shkeljes së pretenduar në lidhje me të drejtën në pronë të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ–së, Gjykata konstatoi se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës i takon pretendimeve „*të pambështetura apo të paarsyetuara*", dhe si të tilla Gjykata në baza kushtetuese i deklaron si qartazi të pabazuara, dhe rrjedhimisht të papranueshme.

Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të deklarohet në tërësinë e saj si qartazi e pabazuar, dhe rrjedhimisht e papranueshme në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI110/20

Parashtrues

Et-hem Bokshi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Plm. nr. 76/2020, të 8 prillit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Et-hem Bokshi nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Ylli Bokshi, avokat nga Gjakova.

2. Gjykata vëren se i njëjti aktgjykim i Gjykatës Supreme është kontestuar edhe ne rastin KI 108 20 ku parashtrues i kërkesës është Luan Kazazi

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Plm. nr. 76/2020 të 8 prillit 2020, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1. nr. 1265/2019 të 12 nëntorit 2019 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë P. nr. 540/13, të 6 qershorit 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (1) (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 9 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 14 korrik 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues në kërkesën e parë, dhe Kolegjin shqyrtues në kërkesën e parë, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu Krasniqi dhe Gresa Caka Nimani.

8. Më 21 korrik 2020, Kryetarja e Gjykatës, në përputhje me rregullin 40 (1) të Rregullores së punës, urdhëroi bashkimin e kërkesave KI108/20 dhe KI110/20, për shkak të faktit se si në kërkesën e parë ashtu edhe në të dytën bëhet fjalë për të njëjtin proces gjyqësor, rrjedhimisht gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues mbeten të njëjtë në të dyja rastet, si në kërkesën KI108/20.

9. Më 10 gusht 2020, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesave për bashkimin e kërkesave dhe në të njëjtën kohë kërkoi nga parashtruesit e kërkesës që të plotësojnë formularin zyrtar të kërkesës dhe t'ia dorëzojnë ato Gjykatës, në të njëjtën datë Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

10. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullin 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të paragrafit 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës nr. KK-SP 71-2/21, u konfirmua që Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani do të merrte pozitën e Kryetares së Gjykatës pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

11. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullin 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu dha dorëheqje nga pozita e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.

12. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin KSH 108/20, e caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci si anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.

13. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohej kryesuese e Kolegjeve shqyrtuese në rastet në të cilët ajo ishte caktuar anëtare e Kolegjit, përfshirë edhe rastin aktual.

14. Më 26 qershor 2021, në bazë të paragrafit 4, të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës Nr. KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori funksionin e Kryetares së Gjykatës, ndërsa në bazë të pikës 1.1, paragrafi 1, i nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi e përfundoi mandatin e Kryetares dhe Gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

15. Më 30 gusht 2021, meqenëse nuk pati përgjigje në shkresën e dërguar më parë të 10 gushtit 2020, Gjykata përsëri i dërgoi një shkresë parashtruesit të kërkesës përmes të cilës e informonte parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe në të cilën ajo përsëri kërkoi nga ai që të plotësojë formularin e kërkesës.

16. Më 10 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës u përgjigj në shkresën e Gjykatës të 30 gushtit 2021 dhe dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ndërsa sa i përket rastit KI 108/20 parashtruesi nuk iu përgjigj kërkesës së dërguar nga Gjykata.

17. Më 7 tetor 2021, në përputhje me rregullin 40 (3) të Rregullores së punës, Gjykata vendosi që t'i shqyrtojë kërkesat KI108/20 dhe

KI110/20 ndarazi, si raste individuale, me të njëjtin gjyqtar raportues dhe Kolegj shqyrtues.

18. Më 12 tetor 2020, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesave në rastet KI108/20 dhe KI110/20 dhe Gjykatën Supreme për ndarjen e kërkesave.

19. Më 3 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Procedurat që janë zhvilluar pranë Administratës Tatimore të Kosovës për shkak të mos-përmbushjes së detyrimeve tatimore

20. Në një datë të pacaktuar, Autoriteti Tatimor i Kosovës (në tekstin e mëtejmë ATK) pas kryerjes së inspektimit dhe llogaritjes së tatimit shtesë, përmes kontrollit ka identifikuar parregullsi në regjistrimin dhe raportimin e të hyrave për vitet fiskale 2008, 2009, 2010 dhe 2011 tek subjekti afarist NPT „Marigona“ në bashkëpronësi të parashtruesve të kërkesës, dhe rrjedhimisht në lidhje me këtë ATK e njoftoi parashtruesin e kërkesës për gjetjet e saj dhe e obligoi atë që të paguajë detyrimet tatimore të identifikuara pas inspektimit si dhe të paguajë gjobën monetare për kundërvajtjen e kryer.

21. Më 12 mars 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër njoftimit të ATK-së në Panelin për Ankesa të ATK-së për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të parregullt të procedurës.

22. Më 2 maj 2012, Paneli për Ankesa i ATK-së, përmes Vendimit nr. 57/2012 e miratoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës në atë mënyrë që e zvogëloi shumën e borxhit për periudhën për vitet fiskale 2008, 2009 dhe 2010, ndërsa borxhi për periudhën e mbetur dhe gjoba për parregullsitë e konstatuara gjatë kontrollit u konfirmuan.

Procedurat që janë zhvilluar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me përgjegjësinë penale të parashtruesit të kërkesës

23. Më 25 mars 2015, Prokuroria Themelore e Gjakovës ngriti aktakuzën nën numrin PP/II. nr. 756/2013 kundër parashtruesit të kërkesës dhe L.K., për veprën penale të shmangies nga tatimi për periudhën kohore nga janari 2007 deri në maj të vitit 2011 në emër të subjektit

afarist NPT „Marigona“ në bashkëpronësi të parashtruesit të kërkesës.

24. Më 11 prill 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit (P. nr. 540/13) e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak se gjatë vitit 2009, e deri në maj të vitit 2011, në cilësinë e drejtorit dhe bashkë-pronarit të subjektit NPT „Marigona“ SH.PK me seli në Gjakovë, i është shmangur raportimit dhe pagesës së tatimit për aktivitetet e tij në biznesin e NPT „Marigona“ SH.PK, ashtu që nuk kanë deklaruar qarkullimin e vërtetë të cilin e kanë pasur në veprimtaritë afariste dhe kësisoj i kanë shkaktuar dëm Administratës Tatimore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë ATK) në periudhën kohore nga janari 2007 deri në fund të vitit 2008, gjykata konstatoi që ndjekja penale kishte arritur parashkrimin absolut.

25. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (P. nr. 540/13) të 11 prillit 2019, ndër të tjera, parashtruesi i kërkesës e bazon ankesën e tij në pretendimin se gjatë gjithë procedurës ai vazhdimisht ka theksuar kundërshtimin e tij ndaj aktakuzës për sa i përket afatit kohor për ngritjen e aktakuzës. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kundërshtoi konkluzionet dhe gjetjet e ekspertit të përfshirë në rastin e tij *“për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale”*.

26. Më 12 nëntor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit (PA 1. nr. 1265/2019) e refuzoi si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

27. Në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit lidhur me afatin kohor të procedurës hetimore, përkatësisht afatin për ngritjen e aktakuzës, thuhet, *“Aktakuza është ngritur brenda afatit 1 vjeçar sikurse parashihet me nenin 69 të ligjit special Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ngase aktvendimi për fillimin e hetimeve PP/II. nr. 756/2012 është marrë me datë 14.05.2013, ndërsa aktakuza PP/II. nr. 756/2012 është dorëzuar në gjykatë me datë 14.11.2013 që do të thotë brenda afatit prej një viti, konform nenit 69 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ndërsa lidhur me aktakuzën PP/II. nr. 756/2012 të datës 25.03.2015 kjo gjykatë vlerëson se nuk kemi të bëjmë me dy aktakuza sikurse pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarve me ankesa, ngase sipas shkresës së prokurorisë së datës 25.03.2015 vërtetohet se vetëm është rregulluar gabimi teknik lidhur me kualifikimin*

juridik te veprës penale, andaj pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale janë të pabazuara".

28. Në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit, që ka të bëjë me kontestimin e konkluzionit të ekspertit financiar A. Sh. , Gjykata e Apelit thekson, *„ekspertit A. Sh., i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: Gjykata e shkallës së parë dëshmisë së ekspertit A. Sh. ia ka falur besimin e plotë për shkak se e njëjta është edhe në harmoni me dëshmitë e dëshmitarëve, sa i përket çështjes se nuk ka qenë kontestues fakti se të akuzuarit si bashkëpronarë të biznesit "Marigona", janë shmangur nga tatimi dhe gjykata e shkallës së parë ekspertit ia ka falur besimin e plotë për shkak se i njëjti në mënyre shumë të qartë ka sqaruar të gjeturat të metat ne raportin e ATK-së dhe në bazë të dokumentacionit që i është ofruar nga ana e Prokurorisë si dhe raportet e inspektorëve të ATK-se, i njëjti ka bërë edhe elaborimin qëndër vite të përmbledhura për shmangien e tatimit dhe obligimeve që janë bërë nga subjekti afarist B "Marigona", në vitet 2005 deri 2010 dhe i njëjti edhe në mënyre tabelore me ekspertizën e tij ka paraqitur shmangie nga tatimi nga subjektet afarist "Marigona", të cilës ekspertizë po ashtu gjykata ia ka falur edhe besimin.*

29. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Supreme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë *për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal,* duke i ngritur të njëjtat pretendime si në procedurën pranë Gjykatës së Apelit në lidhje me afatin përkitazi me ngritjen e aktakuzës, përkatësisht zhvillimin e procedurës hetimore si dhe konstatimet e ekspertit.

30. Më 10 mars 2020, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit përmes parashtresës KMLP. II. nr. 44/2020 propozoi që kërkesa e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

31. Më 8 prill 2020, Gjykata Supreme me aktgjykimin PML. nr. 76/2020 e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të cilën ai e kishte parashtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë të 12 nëntorit 2019 dhe aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë të 11 prillit 2019.

32. Në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të Gjykatës Supreme, që ka të bëjë me afatin kohor të procedurës së hetimit, përkatësisht afatit për ngritjen aktakuzës, thuhet se, *"kjo gjykatë vlerëson se ky pretendim*

i mbrojtësve të të akuzuarve është i pabazuar, pasi aktakuza është ngritur brenda afatit kohor sikurse parashihet me nenin 69 të ligjit special Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ngase aktvendimi për fillimin e hetimeve është marrë me datë 14.05.2013, ndërsa aktakuza është dorëzuar në gjykatë me datë 14.11.2013 që do të thotë brenda afatit prej një viti, konform nenit 69 të këtij Ligji. Lidhur me aktakuzën e dytë të datës 25.03.2015 siç pretendon mbrojtja kjo nuk qëndron, ngase sipas shkresave të lëndës rrjedh se me dokumentin e prokurorisë së datës 25.03.2015 vërtetohet se vetëm është rregulluar gabimi teknik lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale, andaj pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale janë të pabazuara".

33. Në arsyetimin e pjesës së aktgjykimit të Gjykatës Supreme që ka të bëjë me kontestimin e konkluzionit të ekspertit financiar A.Sh., Gjykata Supreme thekson se parashtruesi i kërkesës "*nuk ka dhënë arsye që do të konstatonin kundërthëniet e ekspertizës së ekspertit dhe kontradiktat e tij me provat ashtu siç është pretenduar nga mbrojtja, nga kjo gjykata drejtë ka gjetur se caktimi i një eksperti tjetër ka qenë i panevojshëm për këtë çështje penale, dhe në pajtim me nenin 142 të KPPK-së, gjykata mund të caktoj ekspert tjetër në qoftë se të dhënat dhe konstatimet e ekspertëve ndryshojnë thelbësisht ose kur konstatimet e tyre janë të paqarta, jo të plota apo në kontradiktë me vetveten ose me rrethanat e shqyrtuara e në rast se këto të meta nuk mund të mënjanohen me marrjen e serishme në pyetje të ekspertëve mund të kërkohet mendim i ekspertëve tjerë, e në rastin konkret gjykata drejtë ka vlerësuar se mbrojtja nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me kontradiktat apo konstatimet e ekspertit Ali Shunjaku dhe nuk ka pasur ndonjë ekspert tjetër lidhur me këtë çështje prandaj edhe e ka refuzuar propozimin e mbrojtjes si të pabazuar, dhe pretendimi se është shkelur parimi i „barazisë së armëve" rezulton se është i pabazuar, ngase nuk mund të bëhet fjalë për kurrfarë shkelje të barazisë".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet e kontestuara të gjykatave të rregullta janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut(në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me parimin Ne bis in idem

35. Është shkelur *parimi fondamental: Ne bis in idem, edhe atë për dy arsye, përkatësisht, a) Neni 69 parasheh që kohëzgjatja e hetimit të veprave penale në fushën e tatimeve për përfundimin e hetimeve ndaj veprës penale tatimore është* ***një vit*** *me mundësi të zgjatjes së mëtutjeshme të kohës së tillë shtesë të nevojshme dhe të justifikuar me ndërlikueshmërinë e rastit me vendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake. Në këtë çështje nuk është kontestuese se nuk është paraqitur kërkesë për zgjatje të afatit për hetime dhe meqë hetimet kanë zgjatur më gjatë se një vit, sipas cilësdo aktakuzë. Kjo dispozitë, përveçqë është* ***lex specialis*** *për vepra penale tatimore, është edhe më e favorshme për të pandehurin dhe kjo duhet aplikuar.* ***Në bazë të cekurave****,* ***hetimi duhej pushuar****,-* ***neni 159, paragrafi 1, i KPPRK*** *dhe b) Shkelja tjetër në bazën ne bis in idem qëndron në faktin se pranë ATK-së është zhvilluar procedurë ndëshkimore e Ligjit për Administratën Tatimore të Kosovës [...] për shkak të parregullsive të hasura në kontrollet e zhvilluara tek subjekti afarist "NTB „B-Marigona" me NRB 600204292, i është lëshuar ndëshkimi në vlerë prej 1,000.00 € sipas Ligjit 03/L-222, neni 53, paragrafi 2.4. [...] Kontrolli i ATK-së, argumenton se ATK-ja ka shqyrtua dënim-gjobë, d.m.th. sanksion, e në anën tjetër argumenton se në procedura penale duhej të zhvillohej konform Ligjit Nr. 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale.*

36. Kur bëhet fjalë për shkeljen e parimit *Ne bis in idem*, parashtruesi i kërkesës gjithashtu i referohet edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, konkretisht çështjes *Maresti kundër Kroacisë*, aktgjykimi i 25 qershorit 2009, i cili shtjellon zbatimin e parimit *Ne bis in idem*.

Pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me parimin e barazisë së armëve

37. Raporti i kontestuar është lëshuar nga një ekspert i njëanshëm, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur mundësi efektive që të marrë pjesë në procesin e përgatitjes së ekspertizës, refuzimi i kërkesës për caktimin e ekspertit të ri nuk është arsyetuar fare, andaj është bërë shkelje e parimit të „barazisë së armëve" kundrejt parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me mënyrën e gabuar apo arbitrare të aplikimit të dispozitave ligjore

Në procedurën e hetimeve që i ka paraprirë kallëzimit penal të ATK-së, si dhe gjatë hetimeve nga ana e Prokurorisë së Shtetit, nuk është vepruar në kuptim të nenit 122, paragrafi 2 dhe 132, paragrafi 5.7 të KPPRK-së, paragrafit 5 të KPPRK-së, e një veprim i tillë përbën arbitraritet dhe e bën këtë gjykim të padrejtë dhe jo-korrekt, përkatësisht një veprim i tillë përbën shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ -së (E drejta për një proces të rregullt).

38. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i inicioi këto pretendime në lidhje me ngritjen e aktakuzës, përkatësisht zhvillimin e procedurës hetimore, si dhe konstatimet e ekspertit në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme.

Pretendimet për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

39. Parashtruesi i kërkesës thjesht vetëm pretendon shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së por ai nuk arsyeton apo shpjegon se si ka ardhur deri te shkelja e këtij neni.

40. Parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës që kërkesën e tij ta deklarojë të pranueshme, të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; dhe që aktgjykimet e kontestuara të gjykatave të rregullta të shpallen të pavlefshme.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Protokolli nr. 1 i Konventës për mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut

Neni 1
Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

[...]

Ligji nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat
të 12 korrikut 2010

Neni 69
Kohëzgjatja e hetimit të veprave penale në fushën e tatimeve

Periudha për përfundimin e hetimeve ndaj veprës penale tatimore është një vit me mundësi të zgjatjes së mëtutjeshme të kohës së tillë shtesë të nevojshme dhe e jusitifkuar me ndërlikueshmërinë e rastit me vendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake.

Pranueshmëria e kërkesës

41. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

[...]

43. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara më tej në Ligj, përkatësisht në nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të
ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

44. Për sa i përket përmbushjes së kritereve të lartpërmendura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: 1) është legjitimuar si palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; 2) se i njëjti e konteston kushtetutshmërinë e aktit të autoritetit publik, përkatësisht aktgjykimin e Gjykatës Supreme Plm.nr. 76/2020 të datës 8 prill 2020; 3) se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të fjalisë së dytë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit; 4) se i ka specifikuar në mënyrë të qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, për të cilat pretendon se i janë shkelur, si dhe e ka specifikuar aktin e autoritetit publik, kushtetutshmërinë e të cilit po e konteston, në përputhje me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe 5) e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor prej katër (4) muajsh të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

45. Megjithatë, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe rregullin 39 [Kriteret e Pranueshmërisë], përkatësisht paragrafin (2) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 39
[Kriteret e Pranueshmërisë]

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

46. Gjykata fillimisht vëren se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që t'i shpallë kërkesat të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas

vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

47. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *"qartazi e pabazuar"* ne tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund te ngërthejë. Në ketë drejtim, është më e sakte t'iu referohet te njëjtave si *"pretendime qartazi te pabazuara"*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore te GJEDNJ-se, mund të kategorizohen në katër grupe te veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime *"të shkalles se katërt"*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *"mungese të dukshme ose evidente të shkeljes"*; (iii) pretendime *"të pambështetura apo të paarsyetuara"*; dhe në fund, (iv) pretendime *"konfuze dhe të paqarta"* (shih, rastet e GJEDNJ-së *Kemmachev kundër Francës,* kërkesa nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë,* kërkesa nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe*Trofimchuk kundër Ukrainës*, kërkesanr. 4241/03, kategoria (iii)).

48. Në vlerësimin e pretendimeve të mësipërme, Gjykata do te aplikoje standardet e praktikes gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me te cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

49. Gjykata rikujton se rrethanat e rastit konkret kanë të bëjnë me procedurën penale kundër parashtruesit të kërkesës në lidhje me shmangien nga tatimi apo mos-paraqitjene qarkullimit real të realizuar në kuadër të veprimtarive të zhvilluara të subjektit ekonomik NTP Marigona, i cili është në bashkëpronësi të parashtruesit të kërkesës. Në lidhje me këtë rast, së pari është iniciuar një procedurë administrative pranë ATK-së, për shkak të mos paraqitjes së qarkullimit faktik të realizuar në kuadër të kryerjes së veprimtarive, e ka obliguar atë që ta paguajë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat dhe e ka gjobitur subjektin ekonomik NTP "Marigona" në bashkëpronësi të parashtruesit të parashtruesit të kërkesës, dhe më pas për shkak të së njëjtës vepër, Prokuroria Themelore në Gjakovë ka ngritur aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës dhe partnerit të tij afarist për veprën penale Shmangie Tatimore në Bashkëkryerje. Kjo procedurë penale, e cila ka qenë objekt i kontrollit gjyqësor, ku fillimisht, Gjykata Themelore e shpalli fajtorë parashtruesin e kërkesës dhe partnerin e tij afarist për kryerjen e veprës penale, për të cilën uajo u shqiptoi gjobë dhe dënim burgu me kusht. Në

procedurën e ankimimit, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjithashtu edhe Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, me ç 'rast konstatoi se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta ishin të drejta dhe të ligjshme.

50. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ngre pretendime në lidhje me: *i.* shkeljen e të drejtës së garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me parimin *ne bis idem*; *ii.* shkeljen e të drejtës nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së në lidhje me parimin e *barazisë së armëve*; *iii.* shkeljen e të drejtës së garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me mënyrën e gabuar apo arbitrare të zbatimit të dispozitave ligjore dhe *iv.* shkeljen e të drejtave të garantuara nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

i. Vlerësimi i Gjykatës sa i përket pretendimeve për shkelje të së drejtës së garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me parimin ne bis in idem

51. Gjykata rikujton se parimi *ne bis in idem* garantohet me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale"*

52. Duke analizuar pjesën e parë të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me parimin *ne bis in idem*, Gjykata vëren se sa i përket këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës lidhur me ngritjen e aktakuzës pas afatit ligjor, këto pretendime i ka trajtuar edhe nga Gjykata Supreme, e cila në aktgjykimin e saj deklaroi, "*në bazë të nenit 69 të Ligjit nr. 03-1-222 për administratën tatimore dhe procedurat parashihet që kohëzgjatja e hetimit të veprave penale në fushën e tatimeve për përfundimin e hetimeve ndaj veprës penale tatimore është një vit me mundësi të zgjatjes së mëtutjeshme të kohës së tillë shtesë të nevojshme dhe të justifikuar me ndërlikueshmërinë e rastit*".

53. Marrë parasysh faktin se me këto pretendime parashtruesi i kërkesës ka ngritur çështjen e ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të rregullta, Gjykata thekson se arsyetimin e kësaj pjese të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës do ta jep në pjesën që ka të bëjë me pjesën

e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës që lidhen me pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës në lidhje me aplikimin dhe interpretimin e gabuar të ligjit.

54. Sa i përket pjesës së dytë të pretendimit të parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e parimit *ne bis in idem* për shkak se ai tashmë ishte gjobitur një herë në procedurën administrative për të njëjtën vepër. Gjykata konstaton se në këtë rast bëhet fjalë për dy procedura të ndryshme të cilat janë iniciuar për shkak të mos-paraqitjes së qarkullimit real apo shmangies nga tatimi.

55. Në procedurën administrative dhe penale, ishte konstatuar përgjegjësia e parashtruesit të kërkesës për sjellje të kundërligjshme në bazë të normave të ndryshme juridike dhe kualifikimit juridik. Detyrimi për të paguar tatimin i cili i ishte shqiptuar parashtruesit të kërkesës në procedurën administrative dhe dënimi i shqiptuar parashtruesit të kërkesës në procedurën penale kanë qëllime të ndryshme, përcaktimi i detyrimit për të paguar tatimin (borxhin publik) në procedurë administrative nuk mund të konsiderohet dënim, por një borxh publik i parashtruesit të kërkesës ndaj Shtetit, për çka Gjykata Supreme arsyetoi se "*se ligji penal është aplikuar drejtë, kur të dënuarit E.B. dhe L.K. janë shpallur fajtor për veprën penale shmangie nga tatimi nga neni 249 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK, ngase në veprimet e të dënuarve formësohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale për te cilën janë shpallur fajtor, andaj pretendimet e mbrojtësve të dënuarve përkitazi me shkeljet e ligjit penal dalin të jenë të pabazuara*".

56. Zhvillimi i këtyre dy procedurave ishte i paraparë për parashtruesin e kërkesës dhe parashtruesi i kërkesës që nga fillimi e kishte ditur ose duhej të kishte ditur se deklarimi i fitimeve dhe rrjedhimisht pagesa e tatimit (pagesa e borxhit publik) si dhe ndjekja penale ishin të mundshme.

57. Prandaj, Gjykata konstaton se, eshë psevepra e sjelljes së kundërligjshmee parashtruesit të kërkesës si në procedurën administrative edhe në procedurën penale rrjedh nga faktet dhe ngjarja e njëjtë, pretendimet e parashtruesit për shkelje të parimit *ne bis in idem* në bazë të asaj që është thënë më lartë janë qartazi të pabazuara, sepse, siç mund të konkludohet nga sa më sipër, për të njëjtën çështje janë zhvilluar dy procedura, administrative dhe penale, ndërsa në lidhje me sjelljen e paligjshme të parashtruesit të kërkesës, në bazë të normave ligjore dhe kualifikimeve të ndryshme ligjore.

58. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës për shkak të shkeljes së parimit *ne bis in idem* janë (ii) pretendime që kualifikohen si pretendime që karakterizohen me "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39.

ii. Vlerësimi i Gjykatës sa i përket pretendimeve për shkelje të së drejtës së garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me parimin e barazisë së armëve

59. Gjykata rikujton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me parimin e barazisë se armeve, parashtruesi i kërkesës i ndërlidh me *„raporti i kontestuar është lëshuar nga një ekspert i njëanshëm, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur mundësi efektive që të marrë pjesë në procesin e përgatitjes së ekspertizës, refuzimi i kërkesës për caktimin e ekspertit të ri nuk është arsyetuar fare, andaj është bërë shkelje e parimit të „barazisë së armëve" kundrejt parashtruesit të kërkesës".*

60. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se sipas nenit 6, paragrafi 3, pika (d) të KEDNJ-së, palës nuk i jepet një e drejtë e pakufizuar për t'i dëgjuar dëshmitarët apo për t'i paraqitur provat e tjera para gjykatës, por, sipas rregullit, është detyrë e gjykatave të rregullta të vlerësojnë nëse është e nevojshme që të ftohen dëshmitarët e caktuar, dhe nëse deklaratat e dëshmitarëve të propozuar apo administrimi i provave dhe veprimeve të tjera të propozuara do të ishin relevante dhe të mjaftueshme për vendimmarrje në rastin konkret (shih: GJEDNJ, vendim i pjesshëm për pranueshmëri, i 5 korrikut 2005, *Harutyunyan kundër Armenisë*, nr. 36549/03).

61. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj A. nr. 540/13 ka arsyetuar se, *„për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor ka dëgjuar dëshmitaret: Fadil Alaj dhe Arsim Spahija si dhe ekspertin financiar Ali Shunjaku, si dhe ka administruar provat materiale të propozuara nga palët dhe atë: raporti i kontrollit të ATK-së i datës 23.01.2011 në emër të biznesit N.P.T "Marigona" Gjakovë, libri i blerjes, libri i shitjeve, libri i arkës, të dhënat nga banka, gjendja dhe siktasi si dhe faturat që janë cekur në raportin e kontrollit të datës 23.01.2011, kartelat bankare të cekura ne raportin e gjendjes së kontrollit të datës 23.01.2011, gjendja e siktasit e datës 11.06.2012 që në të konstatohet borxhi total i ndarë në bazë tatimore ndëshkime dhe interes, aktvendimi i bordit*

të pavarur për rishqyrtime me numër A.nr.277 i datës 15.06.2006; ekspertiza e ekspertit financiar Ali Shunjaku e datës 21.08.2013, vendimi i Administratës Tatimore te Kosovës- Departamenti i Ankesave me numër 5712012 i datës 02.05.2012, Aktvendimi i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime në Prishtine me numër A.nr.66/2012 ATK të datës 09.07.2014, si dhe ka dëgjuar mbrojtjen e të akuzuarve Et' hem Bokshi dhe Luan Kazazi".

62. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsyetime të qarta dhe të detajuara, si në lidhje me provat e pranuara, ashtu edhe për sa i përket provave që Gjykata Themelore i hodhi poshtë. Gjykata Supreme këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës e arsyetoi, *"Përkitazi me pretendimin e mbrojtësve se gjykata ka refuzuar propozimin e tyre për caktimin e një ekspertize financiare, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyetimin lidhur me këtë dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme, ngase mbrojtësit nuk kanë dhënë arsye që do të konstatonin kundërthëniet e ekspertizës së ekspertit dhe kontradiktat e tij me provat ashtu siçështë pretenduar nga mbrojtja, nga kjo gjykata drejtë ka gjetur se caktimi i një eksperti tjetër ka qenë i panevojshëm për këtë çështje penale, dhe në pajtim me nenin 142 të KPPK-së, gjykata mund të caktoj ekspert tjetër në qoftë se të dhënat dhe konstatimet e ekspertëve ndryshojnë thelbësisht ose kur konstatimet e tyre janë të paqarta, jo të plota apo në kontradiktë me vetveten ose me rrethanat e shqyrtuara e në rast se këto të meta nuk mund të mënjanohen me marrjen e serishme në pyetje të ekspertëve mund të kërkohet mendim i ekspertëve tjerë, e në rastin konkret gjykata drejtë ka vlerësuar se mbrojtja nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me kontradiktat apo konstatimet e ekspertit Ali Shunjaku dhe nuk ka pasur ndonjë ekspert tjetër lidhur me këtë çështje prandaj edhe e ka refuzuar propozimin e mbrojtjes si të pabazuar, dhe pretendimi se është shkelur parimi i „barazisë së armëve" rezulton se është i pabazuar, ngase nuk mund të bëhet fjalë për kurrfarë shkelje të barazisë".*

63. Gjykata tashmë ka vënë në dukje se gjykatat e rregullta kanë zhvilluar një procedurë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse në të cilën janë paraqitur dëshmitë nga parashtruesi i kërkesës dhe ATK -ja. Për më tepër, gjykatat e rregullta e kanë shqyrtuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për një ekspertizë tjetër të pavarur nga një ekspert tjetër financiar, me arsyetimin se, *"sipas nenit 142 të KPPK-së, gjykata mund të caktoj ekspert tjetër në qoftë se të dhënat dhe konstatimet e ekspertëve ndryshojnë thelbësisht ose kur konstatimet e tyre janë të paqarta, jo të plota apo në kontradiktë me vetveten ose me rrethanat e shqyrtuara e në rast se këto të meta nuk mund të mënjanohen me*

marrjen e serishme në pyetje të ekspertëve mund të kërkohet mendim i ekspertëve tjerë, e në rastin konkret gjykata drejtë ka vlerësuar se mbrojtja nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me kontradiktat apo konstatimet e ekspertit Ali Shunjaku dhe nuk ka pasur ndonjë ekspert tjetër lidhur me këtë çështje prandaj edhe e ka refuzuar propozimin e mbrojtjes si të pabazuar".

64. Ne bazë të asaj që është thënë më sipër, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë dhënë argumente të qarta dhe të sakta në mbështetje të të gjitha gjetjeve dhe konkluzioneve të tyre. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund ta vlerësojë procedurën para gjykatave të rregullta si arbitrare.

65. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij se gjatë procedurave gjyqësore nuk ka përfituar nga një procedurë kontradiktore; se nuk ka pasur mundësi që në faza të ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat ai i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij, që nuk ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare, që gjykatat nuk i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, të cilat shikuar në mënyrë objektive, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kontestuar nuk janë paraqitur në detaje nga ana e Gjykatës Themelore, asaj të Apelit dhe Gjykatës Supreme. Prandaj, Gjykata konsideron se procedura, shikuar në tërësinë e saj, ishte e drejtë (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35394/97, vendim i 4 tetorit 2000).

66. Më tej, Gjykata konsideron se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurave nga ana e gjykatave të rregullta nuk mundet vetvetiu të paraqesë pretendim të argumentueshëm për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, vendimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

67. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij se procedurat relevante në ndonjë mënyre ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, vendimi i 30 qershorit 2009).

68. Rrjedhimisht, Gjykata vie në përfundimin se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me parimin e barazisë së armëve janë (iii) pretendime të cilat kualifikohen si "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39.

iii. Vlerësimi i Gjykatës sa i përket pretendimeve për shkeljen e së drejtës së garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me aplikimin e gabuar ose arbitrar të dispozitave ligjore

69. Në shqyrtimin e këtyre pretendimeve lidhur me interpretimin e gabuar të ligjit, ku parashtruesi i kërkesës pretendon se gjatë hetimeve të kryera nga ana e Prokurorisë së Shtetit, nuk është vepruar në kuptim të nenit 122, paragrafi 2 dhe 132, paragrafi 5.7 të KPPRK-së, paragrafit 5 të KPPRK-së, dhe se nuk janë respektuar normat e nenit 69 të Ligjit nr. 03-1-222 për kohëzgjatjen e hetimit të veprave penale nga fusha e administratës tatimore. Gjykata në radhë të parë thekson se ky pretendim lidhet në thelb me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike zbatimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, pretendime të cilat Gjykata, në përputhje me praktikën e saj gjyqësore si dhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, i konsideron*"pretendime të shkallës së katërt"*.

70. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marre parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së (shih në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2020 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar ne merita; A. Kërkesat qartazi te pabazuara; 2."Shkalla e katërt", paragrafët 281 dhe 288), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkalles së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të *"kushtetutshmërisë"* dhe *"ligjshmërisë"* dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykate e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund te kenë shkelur te drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetute apo me KEDNJ. (shih, ne këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SHA., "Adem Jashari",* Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për

papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi te kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).

71. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikoje konkluzionet e gjykatave te rregullta ne lidhje me gjendjen faktike apoaplikimin e së drejtës materiale dhe se ajo nuk mund te vlerësoje vetë faktet te cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykate e *"shkallës së katërt"*, e që do të rezultonte ne shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih, në lidhje me këtë, rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, të cituar me lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, të cituar me lart, paragrafi 61).

72. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatibile me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-se, *Miragall Escolano dhe te tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; shih gjithashtu edhe rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, të cituar me lart, paragrafi 63). Ne parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka *"aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar"* në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar me *"konkluzione arbitrare"* apo *"qartazi të paarsyeshme"* për parashtruesin përkatës (Për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e *"aplikimit te ligjit ne mënyrë qartazi te gabuar"*, shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të Konventës Evropiane (aspekti civil), të 31 gushtit 2020, Pjesa IV. Kriteret Procedurale; 3. Shkalla e Katërt; b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e Mbikëqyrjes së Gjykatës, paragrafët 329-333; dhe rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, të cituar me lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).

73. Gjykata vëren se lidhur me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit arsyetoi se në rastin e parashtruesit të kërkesës nuk kishte dy aktakuza siç pretendon ai, por se *më*

25.03.2015 vetëm është rregulluar gabimi teknik lidhur me kualifikimin juridik te veprës penale.

74. Gjykata gjithashtu vëren se duke pasur parasysh këto pretendime, Gjykata Supreme arsyetoi se për sa i përket kohëzgjatjes së hetimit, kohëzgjatja e hetimit për kundërvajtjen tatimore është një vit, me mundësinë e zgjatjes së mëtejshme të asaj kohe shtesë të nevojshme dhe të arsyetuar me ndërlikueshmërinë e rastit.

75. Në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, që ka të bëjë me afatin kohor të periudhës së hetimit, theksohet, *"Aktakuza është ngritur brenda afatit 1 vjeçar sikurse parashihet me nenin 69 të ligjit special Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ngase aktvendimi për fillimin e hetimeve PP/II. nr. 756/2012 është marrë me datë 14.05.2013, ndërsa aktakuza PP/II. nr. 756/2012 është dorëzuar në gjykatë me datë 14.11.2013 që do të thotë brenda afatit prej një viti, konform nenit 69 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ndërsa lidhur me aktakuzën PP/II. nr. 756/2012 të datës 25.03.2015 kjo gjykatë vlerëson se nuk kemi të bëjmë me dy aktakuza sikurse pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarve me ankesa, ngase sipas shkresës së prokurorisë së datës 25.03.2015 vërtetohet se vetëm është rregulluar gabimi teknik lidhur me kualifikimin juridik te veprës penale, andaj pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale janë të pabazuara".*

76. Në rrethanat e tilla, duke pasur parasysh pretendimet e bëra nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe faktet e paraqitura na ai, si dhe arsyetimet e gjykatave të rregullt të paraqitura më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij se gjykatat e rregullta mund të kenë *"aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar"*, e që ka rezultuar me konkluzione*"arbitrare"*apo *"qartazi të paarsyeshme"* për parashtruesin e kërkesës, dhe si rrjedhojë, pretendimet e tij për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e *"shkallës së katërt"* dhe si të tilla, pasqyrojnë pretendimet në nivelin e *"ligjshmërisë"* dhe nuk argumentohen në nivelin e *"kushtetutshmërisë"*. Prandaj, ato janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

iv. Vlerësimi i Gjykatës sa i përket pretendimeve për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

77. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës vetëm përmend nenin përkatës të KEDNJ-së, por nuk shtjellon më tej se si dhe pse ka ardhur deri te shkelja e këtij neni përkatës të KEDNJ-së. Shkeljen e këtij neni parashtruesi i kërkesës, në thelb e ndërlidh me aplikimin e pretenduar të gabuar të ligjit, përkatësisht me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës, nenit 6 të Konventës, ndërsa këto pretendime të parashtruesit të kërkesës tashmë janë vlerësuar nga Gjykata si qartazi të pabazuara në përputhje me Kushtetutën (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtruese e kërkesës: *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 52).

78. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se referimi i thjeshtë i neneve të Kushtetutës dhe Konventës dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih,rastin e Gjykatës KI175/20, parashtruese e kërkesës: Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 81; shih rastin e Gjykatës KI166/20, të cituar më lart, paragrafi 51). Prandaj, sa i përket këtyre pretendimeve, Gjykata në pajtim me praktikën e saj e deklaron kërkesën e parashtruesit të kërkesës qartazi të pabazuar dhe rrjedhimisht të papranueshme.

79. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara ngase këto pretendime bien në kategorinë (iii) të pretendimeve "*të pambështetura apo të paarsyetuara*" sepse parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar dhe mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij në lidhje me shkeljet e të drejtave të tij, ai thjesht vetëm ka përmendur një ose më tepër dispozita të KEDNJ-së apo Kushtetutës, pa shpjeguar se në çfarë mënyre janë shkelur ato, prandaj të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

80. Si përfundim, Gjykata në lidhje me pretendimet e parashtruesit për shkelje *i.* të së drejtës së garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe

nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me parimin *ne bis in idem* i kualifikon të njëjtat si pretendime të (ii) kategorisë së dytë që karakterizohen me "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; *ii*. shkelje të së drejtës nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së në lidhje me parimin e barazisë së armëve të njëjtat i kualifikon si pretendime të kategorisë së tretë (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; *iii* shkelje të së drejtës të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ -së në lidhje me aplikimin e gabuar ose arbitrar të dispozitave ligjore i kualifikon të njëjtat si pretendime të kategorisë së parë (i) pretendime të *"shkallës së katërt"*; dhe *iv*. shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ –së, Gjykata i klasifikon të njëjtat si pretendime të kategorisë së tretë (iii) kategori e cila karakterizohet nga pretendime *"të pambështetura apo të paarsyetuara"* dhe si të tilla, ato janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

81. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të deklarohet në tërësinë e saj si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe rrjedhimisht e papranueshme, siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 nëntor 2021, me shumicë votash

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bajram Ljatifi	Gresa Caka-Nimani

KI114/20, Parashtruesi i kërkesës: Aziz Sefedini, Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të: a) Aktgjykimit C1. nr. 190/07 të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 19 tetorit 2010, dhe, b) Aktgjykimit C1. nr. 686/2009 të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 17 nëntorit 2011

KI114/20, Aktvendim për papranueshmëri i 20 tetorit 2021, publikuar më.....

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, mosshterim i mjeteve juridike dhe rast pa objekt shqyrtimi*

Nga shkresat e lëndës rezulton që thelbi i kërkesës së parashtruesit ka të bëjë me dy procedura gjyqësore (kontestimore) të ndjekura nga parashtruesi i kërkesës përkitazi me,

i) anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe pagesën e të ardhurave personale mujore të papaguara për periudhën prej 17 korrikut 1991 deri më 16 qershor 1999, ku si palë e paditur paraqitet edhe "NSH Auto Prishtina",

dhe

ii) të ardhurat personale mujore të papaguara për periudhën prej 10 tetorit 1999 deri më 31 dhjetor 2003, ku si ku si palë e paditur paraqitet Ndërmarrja Shoqërore "Auto Prishtina" (në tekstin e mëtejmë: "NSH Auto Prishtina").

Që të dy këto procedura përfunduan me aktgjykime të formës së prerë të Gjykatave Themelore. Megjithatë, problemi u paraqit gjatë procedurës së përmbarimit të tyre. Parashtruesi i kërkesës së pari inicioi procedurën e përmbarimit të Aktgjykimit të **Gjykatës Themelore C1.nr.190/07** pranë Agjencisë së Privatizimit, gjë të cilën ajo e refuzoi, duke konsideruar se ajo kërkesë ishte jashtë afatit. Parashtruesi ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër vendimit të Agjencisë së Privatizimit, duke kërkuar rishikimin e vendimit të Agjencisë së Privatizimit. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e miratoi ankesën e parashtruesit si të bazuar. Agjencia e Privatizimit ushtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër vendimit të Kolegjit të Specializuar. Kolegji i Apelit e refuzoi ankesën e Agjencisë si të pabazuar dhe urdhëroi Agjencinë e Privatizimit që të përmbarojë aktgjykimin sipas prioriteteve të përcaktuara.

Procedurën e dytë përmbarimore parashtruesi i kërkesës e inicioi pranë Agjencisë së Privatizimit me qëllim të përmbarimit të Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore, C1.nr.686/2009. Agjencia e Privatizimit e refuzoi kërkesën për përmbarimin të parashtruesit të kërkesës duke theksuar

se kërkesa është jashtë afatit. Parashtruesi ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër vendimit të Agjencisë së Privatizimit dhe kërkoi që të rishikohet vendimi i Agjencisë së Privatizimit. Më 9 mars 2021, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin C-II-15-0310-C0001, me të cilin kërkesa e parashtruesit për rishikimin e Vendimit të Agjencisë së Privatizimit PRN126-0242, të 18 majit 2015, u refuzua si e pabazuar.

Më 12 prill 2021, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS ndaj Aktgjykimit C-II-15-0310-C0001 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Gjykata gjeti se procedura përkitazi me ankesën e parashtruesit të kërkesës është ende në pritje të vendimmarrjes pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së. Gjykata arriti në këtë konkludim në bazë të shkresës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të 15 korrikut 2021, që erdhi si rezultat i përgjigjes në shkresën që Gjykata i kishte dërguar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme më 14 korrik 2021.

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendoi se gjykatat me mospërmbarimin e aktgjykimeve të formës së prerë i kishin cenuar të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, parashtruesi i kërkesës theksoi se edhe përkundër *"aktgjykimeve të formës së prerë res judicata përmbarimi është stopuar me veprime jo ligjore dhe në kundërshtim me Kushtetutën e vendit"*.

Gjykata duke analizuar shkresat e lëndës si dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës konkludoi si në vijim. Duke marrë parasysh se procedura përkitazi me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C1.nr.686/2009 aktualisht është duke u zhvilluar pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, konkludoi se kjo pjesë e kërkesës është e parakohshme.

Sa i përket përmbarimit të Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore, C1.nr.190/07, Gjykata konkludoi që të gjitha vendimet janë në favor të parashtruesit të kërkesës, që me vendimet e gjykatave të rregullta tashmë janë përcaktuar të drejtat e tij si dhe organi kompetent që është përgjegjës për përmbarimin e tyre, dhe rrjedhimisht, këtë pjesë të kërkesës Gjykata e shpalli kërkesë pa objekt shqyrtimi.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI114/20

Parashtrues

Aziz Sefedini

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së mospërmbarimit të: a) Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C1. nr. 190/07 të 19 tetorit 2010, dhe, b) Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C1. nr. 686/2009 të 17 nëntorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Aziz Sefedini, nga Prishtina ((në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston mospërmbarimin e dy aktgjykimeve të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), përkatësisht: a) Aktgjykimi i Gjykatës Themelore C1. nr. 190/07, i 19 tetorit 2010 dhe, b) Aktgjykimi i Gjykatës Themelore C1. nr. 686/2009, i Gjykatës Themelore i 17 nëntorit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së procedurës së mospërmbarimit të dy aktgjykimeve të Gjykatës Themelore, përmes të cilave, sipas parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 20 korrik 2020, Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit.

6. Më 21 korrik 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.

7. Më 24 gusht 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 1 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës dërgoi urgjencë në Gjykatë, përmes të cilës kërkoi që Gjykata të nxjerrë një vendim sipas kërkesës së tij sa më shpejt të jetë e mundur, dhe si arsye për këtë, përmendi gjendjen e tij të rëndë shëndetësore.

9. Më 4 shkurt 2021, Gjykata njoftoi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme) për regjistrimin e kërkesës. Përveç kësaj, Gjykata kërkoi nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme: *a) informata specifike në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesës,* dhe*, b) të paraqesë në Gjykatë të*

gjitha vendimet përkatëse në lidhje me procedurat e kryera nga parashtruesi i kërkesës në Dhomën e Posaçme.

10. Të njëjtën ditë, Gjykata gjithashtu i dërgoi një shkresë parashtruesit të kërkesës duke kërkuar informata shtesë në lidhje me kërkesën e tij.

11. Më 8 shkurt 2021, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dërgoi përgjigjet e saj, si dhe vendimet e kërkuara.

12. Më 18 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës gjithashtu dërgoi përgjigjet e tij ndaj kërkesës së gjykatës.

13. Më 28 prill 2021, Gjykata njoftoi Agjencinë e Privatizimit për regjistrimin e kërkesës dhe gjithashtu kërkoi informata në lidhje me procedurat e kryera nga parashtruesi i kërkesës pranë saj.

14. Më 11 maj 2021, parashtruesi i kërkesës dërgoi urgjencë në Gjykatë duke kërkuar që për shkak të gjendjes së tij të rëndë shëndetësore, kërkesa e tij të zgjidhej sa më shpejt që të ishte e mundur.

15. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.

16. Më 19 maj 2021, Agjencia e Privatizimit dërgoi përgjigjet e saj ndaj kërkesës së Gjykatës.

17. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

18. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama–Hajrizi, përmes Vendimit nr. KI48/21, caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu pas dorëheqjes së tij.

19. Më 15 qershor 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë të re Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për sqarime dhe informata shtesë.

20. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

21. Më 1 korrik 2021, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dërgoi sqarime dhe informata në lidhje me shkresën e Gjykatës së 10 qershorit 2021.

22. Më 6 korrik 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë të re Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për të siguruar dokumente dhe aktgjykime të tjera të nevojshme.

23. Më 8 korrik 2021, Gjykata pranoi dokumentet dhe aktgjykimet e kërkuara nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme përmes postës elektronike.

24. Më 14 korrik 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë të re Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme përmes të cilës kërkoi që Dhoma e Posaçme ta njoftojë Gjykatën për të gjitha procedurat e ndërmarra në lidhje me kërkesën e parashtruesit, si dhe për të gjitha vendimet e marra nga Dhoma e Posaçme në lidhje me kërkesën e tanishme.

25. Më 15 korrik 2021, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme përmes postës elektronike dërgoi përgjigje ndaj shkresës së Gjykatës së 14 korrikut 2021.

26. Më 20 tetor 2021, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

27. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se thelbi i kërkesës së parashtruesit ka të bëjë me dy procedura gjyqësore (kontestimore) të ndjekura nga parashtruesi në lidhje me,

iii) anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe pagesën e të ardhurave personale mujore të papaguara

për periudhën prej 17 korrikut 1991 deri më 16 qershor 1999, ku si palë e paditur paraqitet edhe „NSH Auto Prishtina“, dhe

iv) të ardhurat personale mujore të papaguara për periudhën prej 10 tetorit 1999 deri më 31 dhjetor 2003, ku si ku si palë e paditur paraqitet Ndërmarrja Shoqërore "Auto Prishtina" (në tekstin e mëtejmë: "NSH Auto Prishtina").

28. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata do të paraqesë veçmas në vazhdimin e raportit procedurat gjyqësore të kryera nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në procedurën e vendosjes lidhur me kërkesëpaditë, si dhe procedurat gjyqësore të ndjekura nga ai për të ekzekutuar aktgjykimet, si në Agjencinë e Privatizimit, ashtu edhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Procedura e parë gjyqësore e parashtruesit të kërkesës, në lidhje me kërkesëpadinë për anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me "N.SH. "Auto-Prishtina", dhe pagesën e pagave të papaguara mujore për periudhën prej 17 korrikut 1991 deri më 16 qershor 1999

29. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore kundër "*N.SH. "Auto-Prishtina*", përmes së cilës kërkoi anulimin e aktvendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe pagesën e të ardhurave personale të papaguara nga "NSH", për periudhën prej 17 korrikut 1991 deri më 16 qershor 1999.

30. Më 17 nëntor 2011, Gjykata Themelore mbajti seancën kryesore shqyrtuese në të cilën nuk mori pjesë e paditura "*N.SH. "Auto-Prishtina*", pavarësisht faktit, siç thuhet në arsyetimin e Gjykatës Themelore, *„se ajo është ftuar në mënyrë të rregullt në kuptim të nenit 423.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK) nga ana e gjykatës.“*

31. Të njëjtën ditë, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin C1. nr. 686/2009, me të cilin: I. pranoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të bazuar, II. anuloi si të paligjshëm aktvendimin e të padituës "*N.SH. "Auto-Prishtina*". 02-414 të 17 korrikut 1991, përmes të cilit ishte ndërprerë marrëdhënia e punës së parashtruesit të kërkesës, III. Detyroi të padituën "*N.SH. "Auto-Prishtina*" që të kompensojë parashtruesin e kërkesës për pagat mujore të papaguara gjatë kohës kur ai ishte larguar nga puna, përkatësisht nga 17 korriku 1991 deri më 16 maj 1999, në vlerë prej 29,556.08 euro me interes ligjor prej 3.5% t; llogaritur që nga 1 tetori 2006.

32. Në arsyetimin e Aktgjykimit C1. nr. 686/2009, të Gjykatës Themelore thuhet:

> *„E paditura me aktvendimin nr. 02-414 të datës 17.07.1991 ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit, për shkak se me dëshirë e ka lëshuar vendin e punës [...]*
>
> *Në rastin konkret, aktvendimi kontestues me të cilin i është ndërprerë paditësit marrëdhënia e punës tek e paditura ka qenë i kundërligjshëm [...]*
>
> *Gjykata ka konstatuar se paditësi nuk ka bërë shkelje të rëndë të punës dhe atë për shkak se në ditën kur e ka lëshuar vendin e punës, paditësi* (parashtruesi i kërkesës) *ka pasur shenja nga mjeku, se ka qenë i paaftë për atë ditë pune, që ka dalë gjatë orarit të punës, por qëllimi ka qenë që paditësit t'i ndërpritet marrëdhënia e punës dhe atë në bazë të dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi, të cilat kanë qenë diskriminuese dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores së të paditurës dhe Ligjit mbi të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës, neni 59 [...]"*

33. Sa i përket shumës së kompensimit monetar të dhënë parashtruesit të kërkesës, në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore thuhet*:*

> *„[...] si rezultat i ndërprerjes së marrëdhënies së punës, gjykata, sipas propozimit të autorizuarit të paditësit, caktoj ekspertize financiare të cilën e bëri eksperti e autorizuar gjyqësor nga kjo lëmi Sh. B. nga Prishtina e datës; 02.10.2006, me të cilin vërtetohet se lartësia e pagave të parealizuara për punët e kontabilistit të materialit tek e paditura, për kohën kontestuese përkatësisht nga data; 17.07.1991, deri më datë; 16.06. 1999, është në shumën prej 29.556.08 Euro, duke përfshirë edhe kamatën*".

34. Nga shkresat e lëndës, Gjykata gjen se e paditura "*N.SH. "Auto-Prishtina"* nuk kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktgjykimit, C1. nr. 686/2009, të Gjykatës Komunale, me ç'rast ky aktgjykim u bë i plotfuqishëm.

Procedura për përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore C1. nr. 686/2009, kundër "N.SH. "Auto-Prishtina", të cilën e përfaqëson Agjencia e Privatizimit

35. Parashtruesi i kërkesës, përmes përfaqësuesit të autorizuar, inicioi procedurën e përmbarimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C1. nr. 686/2009 të 17 nëntorit 2011, kundër "*N.SH. "Auto-Prishtina"*, të cilën e përfaqëson Agjencia e Privatizimit.

36. Më 31 dhjetor 2012, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin E. nr. 2394/12, përmes të cilit lejohet përmbarimi i Aktgjykimit C1. nr. 686/2009, i Gjykatës Themelore të 17 nëntorit 2011.

37. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 29 korrik 2014, Agjencia e Privatizimit publikoi në gazetat e përditshme "*Kosova Sot"* dhe "*Tribuna"*, si dhe në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Privatizimit, njoftimin ku thuhej "*se ka filluar procedura e likuidimit të "N.SH. "Auto-Prishtina", dhe se afatet për paraqitjen e kërkesave për pretendime që lidhen me likuidim janë deri më 11 shtator 2014"*. Agjencia e Privatizimit publikoi të njëjtin njoftim edhe më 8 gusht 2014.

38. Më 19 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Agjencinë e Privatizimit, si përfaqësuese e "*N.SH. "Auto-Prishtina"*, kërkesë për pagesën e "*pretendimeve për paga të papaguara*" në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore C1. nr. 686/2009.

39. Më 18 maj 2015, Agjencia e Privatizimit nxori Vendimin PRN126-0242, në lidhje me kërkesën për përmbarimin e Aktgjykimit C1. nr. 686/2009, në të cilin thuhej: *"kërkesa përmes të cilës kërkohet kompensim për pagat e papaguara në vlerë prej 29,556.08 € për periudhën prej 17 korrikut 1991 deri më 16.06.1999 me interes ligjor prej 3.5% deri në pagesën përfundimtare dhe shpenzimet e procedurës në vlerë prej 632,00 €, refuzohet si i pavlefshëm, për faktin se kërkesa është paraqitur më 19.09.2014, që është pas afatit për paraqitjen e kërkesave. Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave ishte 11 shtator 2014"*.

40. Për arsyetimin e tillë të vendimit PRN126-0242, Agjencia e Privatizimit deklaroi:

> *"[...] se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur një deklaratë së bashku me dokumentacionin përcjellës ku thuhet se arsyeja për paraqitjen e kërkesës pas afatit është se ai ka pasur probleme serioze shëndetësore kohët e fundit [...]*

Administrata për Likuidim, pas shqyrtimit të raporteve mjekësore të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, së pari përcakton që te Parashtruesi i kërkesës nuk diagnostikohet në asnjë moment ndonjë sëmundje që do ta pengonte plotësisht këtë të fundit të parashtrojë kërkesën brenda afateve [...]

Përveç kësaj, këto raporte nuk mund të konsiderohen një justifikim bindës sepse datat e raportimit ndryshojnë nga raportet e lëshuara në maj 2014, kur N.SH. nuk ishte ende në likuidim deri në raportin e fundit të paraqitur këtu, të datës 26.08.2014. Nga kjo datë deri më 11 shtator 2014, që ishte afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për likuidim, parashtruesi i kërkesës kishte plot 16 ditë të plota për të parashtruar kërkesën brenda afateve të dhëna.

Nga ana tjetër, arsyetimi i parashtruesit të kërkesës se ai duhet të ishte informuar personalisht nga Agjencia Kosovare e Privatizimit është gjithashtu jo bindës. Kjo ndodh sepse autoriteti i likuidimit konsideron se ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të informuar palët e mundshme të interesit, përfshirë edhe parashtruesin e kërkesës.

Neni 35.3 i Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 parasheh: "Nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindës për parashtrim të vonuar, Autoriteti i Likuidimit, në diskrecion vetanak, mund të pranojë Dështminë e Kërkesës apo Interesit të dorëzuar pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave, nëse dështmia e Kërkesës apo Interesit është parashtruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave".

41. Më 12 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kërkesë për rishqyrtimin e vendimit PRN126-0243, të Agjencisë së Privatizimit të 18 majit 2015.

42. Më 6 tetor 2015, Agjencia e Privatizimit parashtroi "*Kërkesë për udhëzim juridik*" në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, duke kërkuar „*nga Dhoma e Posaçme që të jepet një udhëzim lidhur me çështjen se a kanë të drejtë ligjore Gjykata Përmbarimore, Përmbaruesit Privat si dhe institucionet bankare në Republikën e Kosovës që të ekzekutojnë pagesa të fondeve në mirëbesim sa i përket Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat janë në procedurë të Likuidimit nga ana e AKP-së".*

43. Më 15 tetor 2015, me kërkesë të Agjencisë së Privatizimit, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme lëshoi udhëzimin C-IV-15-1607, i cili thotë:

„I. Nga data e parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim, e deri në përfundimin e Likuidimit PEZULLOHET çdo procedurë gjyqësore, administrative apo e arbitrazhit që është kundër ndërmarrjes dhe aseteve të saj që është subjekt i Vendimit për Likuidim, përfshirë edhe procedurat përmbarimore të vendimit të formës së prerë lidhur me kërkesat monetare.

II. Pezullimi i Procedurave nuk aplikohet në rastet e parapara me paragrafin 3 të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit (nr. 04/L-034) për AKP-në.

III. Procedurat e Pezulluara mund të lejohen të vazhdojnë vetëm me miratimin e kërkesës nga Dhoma e Posaçme".

44. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme arsyetoi qëndrimin e saj si më poshtë:

„[...] kolegji konstaton se interpretimi i saktë i këtyre dispozitave nënkupton, kur bëhet fjalë për procedurat gjyqësore, administrative dhe të arbitrazhit, por edhe procedurat përmbarimore, të cilat drejtohen kundër kompanive dhe pronës së tyre që janë objekt i vendimit të likuidimit, këto procedura pezullohen nga data e paraqitjes së njoftimit të vendimit të likuidimit. deri në përfundimin e procedurës së likuidimit.

Zbatimi i këtij ligji është i detyrueshëm jo vetëm për AKP -në dhe gjykatat, por edhe për të gjitha institucionet e tjera, përfshirë bankat, si dhe agjentët përmbarues privatë.

Kur merr propozime të tilla kundër NSH -ve që janë në likuidim në rastet që i bashkëngjiten kërkesës, AKP është e detyruar të reagojë brenda autorizimeve dhe kompetencave ligjore që ka..

Ligji për AKP-në është një ligj i veçantë (Lex Specales) që zbatohet në raste të tilla dhe përjashton zbatimin e të gjitha ligjeve të tjera të përgjithshme (neni 31, paragrafi 1 i këtij ligji)".

45. Më 23 tetor 2015, Agjencia e Privatizimit, pas nxjerrjes së Udhëzimit C-IV-15-1607, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, i dërgoi parashtresë Gjykatës Themelore duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të aktgjykimit C1. nr. 686/2009, duke deklaruar *„se*

debitori ekzekutiv N.SH. "Auto-Prishtina" në Prishtinë është një kompani në pronësi shoqërore dhe është në proces të likuidimit, prandaj Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës lëshoi Udhëzimin nr. C-IV-15-1607 të 15.10.2015. "Nga data e parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim, e deri në përfundimin e Likuidimit PEZULLOHET çdo procedurë gjyqësore, administrative apo e arbitrazhit që është kundër ndërmarrjes dhe aseteve të saj që është subjekt i Vendimit për Likuidim, përfshirë edhe procedurat përmbarimore të vendimit të formës së prerë lidhur me kërkesat monetare" dhe se ndërmarrja e veprimeve përmbarimore mbi fondet e mirëbesimit do të përbënte një shkelje të dispozitave ligjore në fuqi".

46. Në shkresat e lëndës, Gjykata nuk mundi të gjejë nëse Gjykata Themelore kishte vepruar sipas kërkesës së Agjencisë së Privatizimit për të pezulluar përmbarimin e Aktgjykimit C1. nr. 686/2009.

47. Më 16 tetor 2017, Agjencia e Privatizimit parashtroi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundërshtim ndaj kërkesës së parashtruesit për rishikimin e vendimit PRN126-0242, të Agjencisë së Privatizimit të 18 majit 2015, duke deklaruar *„se afati i fundit për paraqitjen e kërkesave në procedurën e likuidimit ishte 11 shtator 2014, ndërsa paditësi e paraqiti kërkesën më 19.09.2014, kështu që kërkesa ishte e pacaktuar. Në këtë drejtim, vendimi i Autoritetit të Likuidimit ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj […]".*

48. Më 9 mars 2021, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin C-II-15-0310-C0001, me të cilin, kërkesa e parashtruesit për rishikimin e vendimit të Agjencisë së Privatizimit PRN126-0242, të 18 majit 2015, u refuzua si e pabazuar.

49. Në arsyetimin e Aktgjykimit, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së deklaroi:

> *"[…] Parashtruesi e dorëzoi kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit më 19 shtator 2014, ku ai kërkoi kompensim në vlerë prej 29,556.08 €, në emër të pagave të papaguara, përkitazi me periudhën prej 17.07.1991 deri më 16.06.1999. Kjo kërkesë është paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e kërkesës, megjithatë, pala paditëse ka deklaruar se e ka parashtruar kërkesën pas afatit sepse kishte probleme shëndetësore.*
>
> *Neni 35.3 i Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 përcakton se nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindës për parashtrim të vonuar, Autoriteti i Likuidimit, në diskrecion vetanak, mund të pranojë Dëshminë e Kërkesës apo Interesit të*

dorëzuar pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave, nëse dëshmia e Kërkesës apo Interesit është parashtruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për kompensim të pagës pas afatit për paraqitjen e kërkesës së bashku me disa prova mjekësore dhe deklaroi se ai nuk ishte në gjendje të paraqiste kërkesën në kohë për shkak të problemeve shëndetësore. Organi i likuidimit e shqyrtoi kërkesën e paraqitur prej tij dhe përcaktoi se arsyet e paraqitura nuk janë bazë për pranimin e kërkesës së paraqitur nga Aziz Sefedini, prandaj refuzoi kërkesën për kompensim të pagës sepse është paraqitur jashtë afatit për paraqitjen e kërkesës".

50. Më 12 prill 2021, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër Aktgjykimit C-II-15-0310-C0001 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duke pretenduar shkelje të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

51. Gjykata gjen se procedura sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës ende është në pritje në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së.

52. Gjykata shpjegon se një përfundim i tillë është arritur në bazë të shkresës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të 15 korrikut 2021, që rezultoi nga përgjigja në shkresën që Gjykata i dërgoi Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme më 14 korrik 2021.

53. Në shkresën e 15 korrikut 2021, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme deklaroi se *"parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit C-II-15-0310, të datës 9 mars 2021, i cili është regjistruar në DHPGJS AC-I-21-0232-A0001. Rasti nën numrin AC-I-21-0232-A0001, iu nënshtrua shortit më 12.05.2021 dhe iu dërgua gjyqtarit dhe çështja do të trajtohet si përparësi e DHPGJS–së".*

Procedura e dytë gjyqësore e parashtruesit të kërkesës në lidhje me kërkesën për pagesën e të ardhurave personale mujore të papaguara për periudhën prej 10 tetorit 1999 deri më 31 dhjetor 2003

54. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore kundër *"NSH Auto Prishtina"*, përmes së cilës kërkoi pagesën e të ardhurave personale të papaguara, për periudhën prej 10 tetorit 1999 deri më 31 dhjetor 2003.

55. Më 19 tetor 2010, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimin kryesor në të cilin nuk mori pjesë e paditura "*NSH Auto Prishtina"* përkundër faktit, siç thuhet në arsyetimin e Gjykatës Themelore, *„se është ftuar në mënyrë të rregulltë nga ana e gjykatës, nuk i është përgjigjur ftesës dhe mosardhjen e saj nuk e ka arsyetuar. Andaj, gjykata shqyrtimin,kryesor të kësaj çështjeje juridike, e ka mbajtur në mungesë të të padituës".*

56. Të njëjtën ditë, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin C. nr. 190/07, aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe konstatoi se parashtruesi ishte në marrëdhënie të punës me të padituën "*NSH Auto Prishtina"*. Të njëjtën kohë, Gjykata Themelore urdhëroi të padituën "*NSH Auto Prishtina"* t'i paguajë parashtruesit të kërkesës shumën prej 35,726.16 euro në emër të të ardhurave personale të papaguara për periudhën prej 10 tetorit 1999 deri më 31 dhjetor 2003.

57. Në arsyetimin e Aktgjykimit C1. nr. 190/07 të Gjykatës Themelore thuhet:

> *"Midis palëve nuk është kontestuese se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune te e paditura qe nga viti 1983 në punë dhe detyra të punës, drejtor deri në vitin 1991, [...]*
>
> *Midis palëve poashtu nuk është kontestuese se paditësi menjëherë pas luftës është lajmëruar në punë te e paditura dhe ka rifillllar punën, nga çka rezulton se ai duhet konsideruar se ishte në marrëdhënie pune te e paditura. Kjo gjykatë vlerëson se midis palëve nuk është kontestues as fakti se paditësit nuk i është lëshuar kurrfarë aktvendimi me ·shkrim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës e as nuk është udhëhequr ndonjë procedurë diciplinore, por i njëjti është urdhëruar nga drejtori administratori, S. Z. se me nuk duhet të shkoi në punë dhe se ai me nuk është punëtor i të padituës pa kurrfarë aresyetimi.*
>
> *Sipas nenit 175 të Ligjit të punës së bashkuar i cili është ligj i aplikueshëm në Kosovë, punëtorit mbi vendimin e marrëdhënies së punës te punëdhënësi duhet ti dorëzohet në formë të shkruar i cili gjithsesi duhet të përmbaj shkaqet për marrjen e tij si dhe duhet të përmbaj udhëzimin mbi të drejtën e kundërshtimit të atij vendimi".*

58. Sa i përket shumës së kompensimit monetar të dhënë parashtruesit të kërkesës, në arsyetimin e Gjykatës Themelore theksohet:

"nga ekspertiza e ekspertit financiar Sh.B, rezulton se detyrimet në emër të të ardhurave personale dhe kamatës për periudhën 18.10.1999 deri më 31.12.2003 të paditurës ndaj paditësit janë gjithsejt 35.725,16 euro."

59. Nga shkresat e lëndës, Gjykata konstaton se e paditura "*NSH Auto Prishtina"* nuk ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale C1. nr. 190/07, me ç'rast i njëjti u bë i plotfuqishëm.

Procedura për përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore C1. nr. 190/07, kundër "NSH Auto Prishtina", të cilën e përfaqëson Agjencia e Privatizimit

60. Parashtruesi i kërkesës, përmes përfaqësuesit të autorizuar, inicioi procedurën e përmbarimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C1. nr. 190/07 të 19 tetorit 2010, kundër *"NSH Auto Prishtina"* të përfaqësuar nga Agjencia e Privatizimit.

61. Më 26 shkurt 2013, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin E. nr. 791/12, përmes të cilit lejoi ekzekutimin e Aktgjykimit C1. nr. 190/07, të 19 tetorit 2010.

62. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 29 korrik 2014, Agjencia e Privatizimit publikoi në gazetat e përditshme "*Kosova Sot"* dhe "*Tribuna"*, si dhe në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Privatizimit, njoftimin ku thuhej "*se ka filluar procedura e likuidimit të ""N.SH. "Auto-Prishtina", dhe se afatet për paraqitjen e kërkesave për pretendime që lidhen me likuidim janë deri më 11 shtator 2014"*. Agjencia e Privatizimit publikoi të njëjtin njoftim edhe më 8 gusht 2014.

63. Më 19 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Agjencinë e Privatizimit, si përfaqësuese e "*NSH Auto-Prishtina"*, kërkesë për pagesën e "*pretendimeve për paga të papaguara*" në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore C1. nr. 190/07.

64. Më 18 maj 2015, Agjencia e Privatizimit nxori Vendimin PRN126-0243, me të cilin kërkesa për ekzekutimin e Aktgjykimit C1. nr. 190/07 në lidhje me pagesën e pagave të papaguara në vlerë prej 35.725,16 € për periudhën prej 18 tetorit 1999 deri më 31 dhjetor 2003, dhe shpenzimet e procedurës në vlerë prej 969,20 €, refuzohet si e pavlefshme, me arsyetimin se "*kërkesa është paraqitur më 19.09.2014, që është pas afatit për paraqitjen e kërkesave. Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave ishte 11.09.2014"*.

65. Për qëndrimin e tillë, në aktvendimin PRN126-0243, Agjencia e Privatizimit përmendi argumentet si në vijim:

"[...] se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur një deklaratë së bashku me dokumentacionin përcjellës ku thuhet se arsyeja për paraqitjen e kërkesës pas afatit është se ai ka pasur probleme serioze shëndetësore kohët e fundit [...]

Administrata për Likuidim, pas shqyrtimit të raporteve mjekësore të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, së pari përcakton që te Parashtruesi i kërkesës nuk diagnostikohet në asnjë moment ndonjë sëmundje që do ta pengonte plotësisht këtë të fundit të parashtrojë kërkesën brenda afateve.

Përveç kësaj, këto raporte nuk mund të konsiderohen një justifikim bindës sepse datat e raportimit ndryshojnë nga raportet e lëshuara në maj 2014, kur N.SH. nuk ishte ende në likuidim deri në raportin e fundit të paraqitur këtu, të datës 26.08.2014. Nga kjo datë deri më 11 shtator 2014, që ishte afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për likuidim, parashtruesi i kërkesës kishte plot 16 ditë të plota për të parashtruar kërkesën brenda afateve të dhëna.

Nga ana tjetër, arsyetimi i parashtruesit të kërkesës se ai duhet të ishte informuar personalisht nga Agjencia Kosovare e Privatizimit është gjithashtu jo bindës. Kjo ndodh sepse autoriteti i likuidimit konsideron se ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të informuar palët e mundshme të interesit, përfshirë edhe parashtruesin e kërkesës.

Neni 35.3 i Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 parasheh: "Nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindës për parashtrim të vonuar, Autoriteti i Likuidimit, në diskrecion vetanak, mund të pranojë Dëshminë e Kërkesës apo Interesit të dorëzuar pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave, nëse dëshmia e Kërkesës apo Interesit është parashtruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas Afatit për Parashtrimin e Kërkesave".

66. Më 12 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) kërkesë për rishikimin e vendimit PRN126-0243, të Agjencisë së Privatizimit të 18 majit 2015.

67. Më 6 tetor 2015, Agjencia e Privatizimit parashtroi "*Kërkesë për udhëzim juridik*" në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, duke kërkuar „*nga Dhoma e Posaçme që të jepet një udhëzim lidhur me çështjen se a kanë të drejtë ligjore Gjykata Përmbarimore, Përmbaruesit Privat si dhe institucionet bankare në Republikën e Kosovës që të ekzekutojnë pagesa të fondeve në mirëbesim sa i përket Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat janë në procedurë të Likuidimit nga ana e AKP-së*".

68. Më 15 tetor 2015, me kërkesë të Agjencisë së Privatizimit, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme lëshoi udhëzimin C-IV-15-1607, i cili thotë:

> *"I. Nga data e parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim, e deri në përfundimin e Likuidimit PEZULLOHET çdo procedurë gjyqësore, administrative apo e arbitrazhit që është kundër ndërmarrjes dhe aseteve të saj që është subjekt i Vendimit për Likuidim, përfshirë edhe procedurat përmbarimore të vendimit të formës së prerë lidhur me kërkesat monetare.*
>
> *II. Pezullimi i Procedurave nuk aplikohet në rastet e parapara me paragrafin 3 të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit (nr. 04/L-034) për AKP-në.*
>
> *III. Procedurat e Pezulluara mund të lejohen të vazhdojnë vetëm me miratimin e kërkesës nga Dhoma e Posaçme".*

69. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme arsyetoi qëndrimin e saj si më poshtë:

> *„[...] kolegji konstaton se interpretimi i saktë i këtyre dispozitave nënkupton, kur bëhet fjalë për procedurat gjyqësore, administrative dhe të arbitrazhit, por edhe procedurat përmbarimore, të cilat drejtohen kundër kompanive dhe pronës së tyre që janë objekt i vendimit të likuidimit, këto procedura pezullohen nga data e paraqitjes së njoftimit të vendimit të likuidimit. deri në përfundimin e procedurës së likuidimit.*
>
> *Zbatimi i këtij ligji është i detyrueshëm jo vetëm për AKP -në dhe gjykatat, por edhe për të gjitha institucionet e tjera, përfshirë bankat, si dhe përmbaruesit privatë.*
>
> *Kur merr propozime të tilla kundër NSH -ve që janë në likuidim në rastet që i bashkëngjiten kërkesës, AKP është e detyruar të reagojë brenda autorizimeve dhe kompetencave ligjore që ka.*

Ligji për AKP-në është një ligj i veçantë (Lex Specales) që zbatohet në raste të tilla dhe përjashton zbatimin e të gjitha ligjeve të tjera të përgjithshme (neni 31, paragrafi 1 i këtij ligji)".

70. Më 23 tetor 2015, Agjencia e Privatizimit, pas nxjerrjes së Udhëzimit C-IV-15-1607, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, i dërgoi parashtresë Gjykatës Themelore duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të aktgjykimit C1. nr. 190/07, duke deklaruar *„se debitori ekzekutiv N.SH. "Auto-Prishtina" në Prishtinë është një kompani në pronësi shoqërore dhe është në proces të likuidimit, prandaj Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës lëshoi Udhëzimin nr. C-IV-15-1607 të 15.10.2015. "Nga data e parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim, e deri në përfundimin e Likuidimit PEZULLOHET çdo procedurë gjyqësore, administrative apo e arbitrazhit që është kundër ndërmarrjes dhe aseteve të saj që është subjekt i Vendimit për Likuidim, përfshirë edhe procedurat përmbarimore të vendimit të formës së prerë lidhur me kërkesat monetare" dhe se ndërmarrja e veprimeve përmbarimore mbi fondet e mirëbesimit do të përbënte një shkelje të dispozitave ligjore në fuqi".*

71. Më 16 tetor 2017, Agjencia e Privatizimit parashtroi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundërshtim ndaj kërkesës së parashtruesit për rishikimin e vendimit PRN126-0242, të Agjencisë së Privatizimit të 18 majit 2015, duke deklaruar *„se afati i fundit për paraqitjen e kërkesave në procedurën e likuidimit ishte 11 shtator 2014, ndërsa paditësi e paraqiti kërkesën më 19.09.2014, kështu që kërkesa ishte e pacaktuar. Në këtë drejtim, vendimi i Autoritetit të Likuidimit ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj […]".*

72. Më 14 mars 2018, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin C-IV-15-1027, me të cilin pranoi si të bazuar kërkesën e parashtruesit për rishikimin e Vendimit PRN126-0243 të Agjencisë së Privatizimit të 18 majit 2015 , lidhur me përmbarimin e aktgjykimit C1. nr. 686/2009, II. shfuqizoi Vendimin PRN126-243 të 18 majit 2018, dhe III. e detyroi Autoritetin e Likuidimit të Agjencisë së Privatizimit, *„për të paguar kompensim për pagat e papaguara për periudhën prej 18 tetorit 1999 deri më 31 dhjetor 2003, për t'i paguar paditësit shumën prej 35,725.16 euro, si dhe shpenzimet procedurale në vlerë prej 969.20 euro".*

73. Në arsyetimin e aktgjykimit, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së deklaroi *„se në këtë rast nuk ka kontest për kërkesat për të ardhurat e papaguara në procedurat e likuidimit, pasi kjo çështje u shqyrtua në një procedurë tjetër gjyqësore të inicuar në 2001 dhe rezultoi në*

Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prishtinë më 19 tetor 2010, me të cilin është aprovuar kërkesa e paditësit për pagat e papaguara nga NSH -ja në vlerë prej 35,725.16 euro.
[...]
Kolegji i Specializuar konstatoi se AKP-ja nuk e ka përmbushur obligimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës, prandaj nuk mund të pretendojë që parashtruesi i kërkesës e ka humbur afatin për dorëzimin e kërkesës.

74. Më 26 mars 2018, Agjencia e Privatizimit parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i DHPGJS) kundër aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS -së, C -IV. -15-1027. Në ankesë, Agjencia e Privatizimit deklaroi, "*se argumenti se kërkesa është parashtruar pas afatit të caktuar është i mjaftueshëm për të refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe për të mbështetur vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Gjithashtu, Agjencia e Privatizimit shton se Kolegji i Specializuar i DHPGJS -së, në shumë raste të jurisprudencës së tij, theksoi rëndësinë e respektimit të afatit për paraqitjen e kërkesave në Autoritetin e Likuidimit, duke iu referuar disa rasteve, prandaj ky Aktgjykim është në kundërshtim me praktikën gjyqësore*".

75. Më 28 mars 2018, Gjykata Themelore miratoi kërkesën e Agjencisë së Privatizimit të 23 tetorit 2015 për të pezulluar përmbarimin e Aktgjykimit C1. nr. 190/07. Gjithashtu, Gjykata Themelore nxori konkluzionin E. nr. 2394/12, përmes të cilit *„I. Pezullohet, procedura në këtë çështje përmbarimore, deri sa të përfundoj procedura e likuidimit ndaj debitorit të përmbarimit: N.SH. „Auto-Prishtina". II. Procedura në këtë çështje përmbarimore do te vazhdoi, pas njoftimit se ka përfunduar procedura e likuidimit ndaj debitorit të përmbarimit N.SH. „Auto-Prishtina". III. Kreditori i përmbarimit, obligohet t'a njoftoi gjykatën me shkrim se procedura e likuidimit ndaj debitorit të përmbarimit ka përfunduar, ashtu që gjykata te vazhdoi me zbatimin e përmbarimit*".

76. Në arsyetimin e konkluzionit E. nr. 2394/12 të Gjykatës Themelore thuhet:

> *„[...] pas vlerësimit të parashtresës së dt:23.10.2015, shkresave tjera në lëndë dhe mbi bazën e asaj që është thënë më lart, erdhi në përfundim se procedura në këtë çështje përmbarimore duhet*

të pezullohet deri sa të përfundoi procedura e likuidimit ndaj debitorit të përmbarimit ...”

77. Më 5 dhjetor 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin AC-I-18-0184, duke refuzuar ankesën e Agjencisë së Privatizimit si të pabazuar në pikën I, vërtetoi Aktgjykimin Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-15- 1027, në pikën II. të dispozitivit të Aktgjykimit C-IV-15-1027, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së shtoi tekstin, ku në fund të fjalisë, sipas detyrës zyrtare, shtohet teksti me përmbajtje të mëposhtme: *„sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit“*.

78. Në arsyetimin e Aktgjykimit AC-I-18-0184, Kolegji i Apelit i DHPGJS theksoi:

„Kolegji i Apelit e konsideron se konkluzioni i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të dhënë në Aktgjykimin e ankimuar se detyra e AKP-së, në pajtim me nenin 7.4 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të njoftojë paditësin në lidhje me njoftimin e likuidimit dhe afatin për paraqitjen e kërkesës bazuar në njoftimin e publikuar, në procesin e likuidimit, veçanërisht kur AKP tashmë e dinte që paditësi kishte një Aktgjykim të formës së prerë mbi kërkesën e tij të paraqitur më herët kundër NSH -së. Prandaj, mund të konkludohet se Agjencia nuk e përmbushi detyrimin ligjor që tanimë e kishte ndaj paditësit pas publikimit të njoftimit për paraqitjen e kërkesës.

Kolegji i Apelit vëren më tej se paditësi vërtetoi me prova se ai kishte dhe ka ende probleme shëndetësore, kështu që në rrethana të tilla paraqitja e tij në Autoritetin e Likuidimit me disa ditë vonesë nuk është një arsye e vlefshme dhe legjitime për refuzimin e kërkesës për shkak të afatit Me mosuskesin e vetë AKP së për të informuar paditësin për mundësinë për të paraqitur kërkesë nuk mund të mbulohet me pretendimin se paditësi nuk e ka përmbushur afatin, kur ai tashmë e dinte që paditësi kishte një kërkesë legjitime për fitime bazuar në një Aktgjykim të plotfuqishëm, i cili është detyrues dhe duhet të zbatohet nga palët.

Kolegji i Apelit, në Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-15-1027 të 14 marsit 2018, në pikën II të dispozitivit, pas përfundimit të fjalisë së kësaj pike, sipas detyrës zyrtare shtoi edhe fjalinë me tekstin e mëposhtëm: “sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit“.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

79. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat me mospërmbarimin e aktgjykimeve të plotfuqishme kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

80. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, parashtruesi i kërkesës shton se përkundër *"aktgjykimeve të formës së prerë res judicata përmbarimi është stopuar me veprime jo ligjore dhe në kundërshtim me Kushtetutën e vendit"*.

81. Në kontekstin e sa më sipër, parashtruesi i kërkesës shton *"se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv të garantuar me Kushtetutë dhe GJEDNJ për shkak të mospërmbarimit për një periudhë kaq të gjatë kohore, edhepse gjykata kompetente është informuar për gjendjen tejet të rëndë shëndetësore të parashtruesit"*.

82. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se *"është e papranueshme, joligjore që Gjykata Kompetente në Prishtinë, të prolongojë ekzekutimin lëndëve në kontekst edhe pse si shihet nga shkresat e bashkangjitura, më parë e njëjta Gjykatë ka lejuar përmbarimin"*.

83. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata: *„i) Vlerësimin e kushtetutshmërisë të mos-përmbarimit të lëndëve në kontest për një periudhë kaq të gjatë kohore, ii) që Gjykata të konkludojë se është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv të garantuar me Kushtetutë, iii) që Gjykata duhet të veproj konform Kushtetutës së vendit, të prekë ndërgjegjen e Gjykatës Kompetente dhe të bëjë ekzekutimin e lëndëve në kontest "*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

84. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

85. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

86. Gjykata gjithashtu u referohet kritereve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari u referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".

87. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata së pari thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston mosekzekutimin e dy aktgjykimeve të formës së prerë të Gjykatës Themelore, përkatësisht: a) Aktgjykimit C1. nr. 190/07, të 19 tetorit 2010 dhe, b) Aktgjykimit C1. nr. 686/2009, të 17 nëntorit 2011. Parashtruesi gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

88. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, vlerësimit nëse kërkesa e tanishme është e pranueshme ose qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të

Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

89. Duke iu kthyer vetë thelbit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me dy procedura kontestimore, të cilat kanë të njëjtin thelb, por rrugë të ndryshme procedurale, si dhe rezultate të ndryshme në rrethanat aktuale që i përcaktojnë ato dhe aktgjykime të ndryshme gjyqësore, do të vlerësojë veç e veç kushtet e pranueshmërisë dhe do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kushtet e shterimit të mjeteve juridike në lidhje me të dy procedurat kontestimore. Në fund, Gjykata do të vlerësojë veçanërisht pretendimet e parashtruesit në lidhje me mosekzekutimin e "*aktgjykimit res judicata për një periudhë më të gjatë kohore*".

(i) përkitazi me procedurën gjyqësore në lidhje me përmbarimin e aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore C1. nr. 686/2009, i cili doli si rezultat i procedurës gjyqësore të iniciuar nga parashtruesi me kërkesëpadinë për anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me "NSH "Auto-Prishtina", dhe pagesën e pagave të papaguara mujore për periudhën prej 17 korrikut 1991 deri më 16 qershor 1999

90. Në lidhje me procedurën gjyqësore përkitazi me përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë C1. nr. 686/2009 të Gjykatës Themelore, Gjykata duke u bazuar në parimet e përgjithshme përkitazi me shterimin e mjeteve juridike, siç janë shtjelluar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, Gjykata së pari do të vlerësoj nëse parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parashikuara me ligj. Gjykata i ka shtjelluar këto parime në mënyrë të detajuar në një numër rastesh, duke përshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI108/18, parashtrues *Blerta Morina*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 shtatorit 2019; KI147/18, parashtrues *Artan Hadri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 tetorit 2019; KI211/19, parashtrues *Hashim Gashi, Selajdin Isufi, B.K., H.Z., M.H., R.S., R.E., S.O., S.H., H.I., N.S., S.I., dhe S.R,* Aktvendim për papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020; KI43/20, parashtruese *Fitore Sadikaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 gushtit 2020; dhe KI42/20, parashtrues *Armend Hamiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 gushtit 2020.

91. Sa i përket kësaj procedure kontestimore, Gjykata së pari u referohet kritereve të pranueshmërisë, të parapara me Ligj. Në këtë drejtim,

Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit, i cili përcakton:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

92. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(1) "Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar,

93. Gjykata më tej konstaton se në procedurën e përmbarimit të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore C1. nr. 686/2009, parashtruesi i kërkesës inicioi procedurën përmbarimore edhe tek autoriteti kompetent, përkatësisht Agjencia Kosovare e Privatizimit, e cila me Vendimin PRN126-0242, kontestoi ekzekutueshmërinë e aktgjykimit C1. nr. 686/2009 duke konsideruar se parashtruesi i kërkesës e kishte iniciuar procedurën e përmbarimit të tij pas afatit. Për të realizuar të drejtat e tij sipas aktgjykimit të formës së prerë, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për rishikimin e vendimit PRN126-0242 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në Kolegjin e Specializuar të Gjykatës Supreme, si instancë gjyqësore kompetente e cila ka juridiksion ekskluziv të merret me vendimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

94. Gjykata gjen se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, si kolegji i shkallës së parë i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, më 9 mars 2021,

nxori Aktgjykimin C-II-15-0310-C0001, me të cilin kërkesën e parashtruesit për rishikimin e vendimit PRN126-0242 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit e refuzoi si të pabazuar.

95. Sa i përket rrugës procedurale të mëtejshme të parashtruesit të kërkesës, Gjykata me këtë rast duhet të rikujtojë se me qëllim të mbledhjes së të gjitha dokumenteve dhe vendimeve gjyqësore, më 14 korrik 2021 i dërgoi një shkresë shtesë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, së cilës e njëjta iu përgjigj më 15 korrik 2021. Gjykata rikujton se në përgjigjen e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të 15 korrikut 2021 thuhet në mënyrë decidive:

> *"[...] parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit C-II-15-0310, të datës 9 mars 2021, i cili është regjistruar në DHPGJS AC-I-21-0232-A0001. Rasti nën numrin AC-I-21-0232-A0001, iu nënshtrua shortit më 12.05.2021 dhe iu dërgua gjyqtarit dhe çështja do të trajtohet si përparësi e DHPGJS –së".*

96. Bazuar në përgjigjen e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Gjykata vetëm mund të konkludojë se procedura e parashtruesit të kërkesës në lidhje me ekzekutimin e Aktgjykimit C1. nr. 686/2009 të Gjykatës Themelore të 17 nëntorit 2011 është në pritje në vendimmarrje para Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së. Gjykata këtu veçanërisht dëshiron të citojë përfundimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nga përgjigja e 15 korrikut 2021, ku thuhet se "*çështja do të trajtohet me prioritet nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme*", dhe Gjykata nuk ka arsye të dyshojë se nuk do të jetë kështu.

97. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit në lidhje me mosekzekutimin e Aktgjykimit C1. nr. 686/2009 të Gjykatës Themelore, që lindi si rezultat i procedurës gjyqësore të iniciuar nga parashtruesi me kërkesëpadi për anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me "N.SH. "Auto-Prishtina", dhe për pagesën e pagave mujore të papaguara për periudhën prej 17 korrikut 1991 deri më 16 qershor 1999, është e parakohshme.

98. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.

99. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre gjatë procedurës së rregullt gjyqësore para se çështja të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në ligjin kombëtar apo jo (shih, *inter alia, Aksoy kundër Turqisë*, paragrafi 51, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 18 dhjetorit 1996).

100. Parimi është që mekanizmi mbrojtës i krijuar nga Gjykata Kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, ndër të tjera, *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 7 dhjetorit 1976).

101. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë një rrugë të rregullt deri te mjetet juridike të cilat janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të siguruar një mundësi për të korrigjuar shkeljet e pretenduara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë këtyre mjeteve juridike do t'u mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm (shih, *inter alia*, *Vernillo kundër Francës*, paragrafi 27 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 20 shkurtit 1991, dhe *Dalia kundër Francës*, paragrafi 38 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 19 shkurtit 1998). Gjykata thekson se ky konkludim i gjykatës në lidhje me këtë procedurë gjyqësore përkitazi me ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore C1. nr. 686/2009 nuk e pengon parashtruesin e kërkesës që në të ardhmen, sërish, të dorëzojë kërkesë kushtetuese brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor nga dita kur do të pranojë vendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së. Ky vendim i Gjykatës konstaton që, tani për tani, kërkesa e parashtruesit është e parakohshme për arsye se legjislacioni në fuqi parasheh mjete juridike efektive, përmes së cilave parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij ligjore dhe kushtetuese.

102. Prandaj, Gjykata konkludon se pjesa e kërkesës përkitazi me procedurën e iniciuar nga parashtruesi me kërkesën për ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë C1. nr. 686/2009 të Gjykatës Themelore, e cila u ngrit si rezultat i procedurës gjyqësore të iniciuar nga parashtruesi me kërkesëpadinë për anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me "NSH "Auto-Prishtina", dhe pagesën e pagave mujore të papaguara për periudhën prej 17 korrikut 1991 deri më 16 qershor 1999, është e papranueshme, në baza kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, siç

parashihet me nenin 47 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

(ii) sa i përket procedurës gjyqësore në lidhje me përmbarimin e aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore C1. nr. 190/07, e cila u ngrit si rezultat i procedurës gjyqësore të cilën parashtruesi i kërkesës e inicioi me kërkesëpadi për pagesën e të ardhurave të papaguara mujore për periudhën prej 10 tetorit 1999 deri më 31 dhjetor 2003

103. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës inicioi procedurë kontestimore në Gjykatën Themelore me qëllim që të realizojë të drejtat e tij për pagesën e të ardhurave personale për periudhën prej 10 tetorit 1999 deri më 31 dhjetor 2003. Gjykata konstaton se Gjykata Themelore pranoi kërkesën e parashtruesit dhe më 19 tetor 2010 nxori Aktgjykimin C1. nr. 190/7, i cili u bë përfundimtar, duke pasur parasysh se e paditura nuk parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut.

104. Gjykata më tej konstaton se në procedurën e ekzekutimit të aktgjykimit përfundimtar të Gjykatës Themelore C1. nr. 190/7, parashtruesi i kërkesës inicioi procedurën përmbarimore para autoritetit kompetent, respektivisht Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e cila kontestoi ekzekutueshmërinë e Aktgjykimit C1. nr. 190/7, me Vendimin PRN126-0243, duke konsideruar se parashtruesi e kishte filluar procedurën e ekzekutimit të aktgjykimit pas afatit. Për të realizuar të drejtat e tij që i takonin sipas aktgjykimit përfundimtar, parashtruesi parashtroi kërkesë për rishikimin e vendimit PRN126-0243 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, si instancë kompetente gjyqësore që ka juridiksion ekskluziv për t'u marrë me vendimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

105. Gjykata gjen se Kolegji i Specializuar i DHPGJS, si kolegj i shkallës së parë i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, më 14 mars 2018, nxori Aktgjykimin C-IV-15-1027, me të cilin në pikën I. pranoi si të bazuar kërkesën e parashtruesit për rishikimin e Vendimit PRN126-0243 të Agjencisë së Privatizimit të 18 majit 2015, në pikën II. shfuqizoi Vendimin PRN126-243 të 18 majit 2018, dhe në pikën III. e detyroi Autoritetin e Likuidimit të Agjencisë së Privatizimit,„ *për të paguar kompensim për pagat e papaguara për periudhën prej 18 tetorit 1999 deri më 31 dhjetor 2003, për t'i paguar paditësit shumën prej 35,725.16 euro, si dhe shpenzimet procedurale në vlerë prej 969.20 euro".*

106. Gjykata më tej konstaton se pala e pakënaqur, në këtë rast Agjencia e Privatizimit, paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS kundër Aktgjykimit C-IV-15-1027, të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, të cilën Kolegji i Apelit më 5 dhjetor 2019 me Aktgjykimin AC-I -18-0184, e refuzoi si të pabazuar, me çka parashtruesi i kërkesës i shteroi të gjitha mjetet juridike në procedurën e ekzekutimit të aktgjykimit përfundimtar të Gjykatës Themelore C1. nr. 190/7.

107. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata në pjesën e mëtejmë të aktvendimit do të shqyrtojë dhe analizojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, në lidhje me procedurën e mosekzekutimit të aktgjykimit përfundimtar C1. nr. 190/7 të Gjykatës Themelore, e cila rezulton nga një procedurë gjyqësore e iniciuar nga parashtruesi me një kërkesëpadi për pagesën e pagave mujore të papaguara për periudhën prej 10 tetorit 1999 deri më 31 dhjetor 2003.

108. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës në lidhje me kërkesën ka të bëjë me faktin se ai ka aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore të 19 tetorit 2010, i cili njëherit është edhe *res judicata* dhe të cilin nuk mund ta përmbarojë "*për një periudhë më të gjatë kohore*" .

109. Duke i sjellë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me faktet konkrete, Gjykata rikujton se neni 6 i KEDNJ-së, në pjesën relevante thekson,

> "*1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...*"

110. Nga të lartcekurat është e qartë që kushti për zbatimin e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së është që në këtë procedurë të jenë përcaktuar "*të drejtat dhe detyrimet civile*". Prandaj, në këtë rast, shtrohet pyetja nëse janë përcaktuar "*të drejtat dhe detyrimet e tij civile*" në rastin e parashtruesit të kërkesës dhe rrjedhimisht nëse nenet 31 të Kushtetutës dhe 6 të KEDNJ-së janë të zbatueshëm.

111. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila parasheh që zbatueshmëria e nenit 6 paragrafi 1 në çështjet civile varet së pari nga ekzistenca e një "kontesti" (në frëngjisht "*contestation*"). Së dyti, kontesti duhet të ketë lidhje me një të "drejtë" e cila mund të thuhet, të paktën në kuptimin e një pretendimi që mund

të dëshmohet, është e njohur në të drejtën e brendshme, pavarësisht nëse mbrohet apo jo me Konventë. Kontesti duhet të jetë i vërtetë dhe serioz; mund të ndërlidhet jo vetëm me ekzistimin e një të drejte por edhe me shkallën e asaj të drejtë dhe me mënyrën e realizimit të saj. Në fund, rezultati i procedurës duhet të jetë i tillë që të jetë drejtpërdrejt vendimtar për të drejtën "civile" në fjalë sepse një lidhje e dobët ose pasoja të paqarta nuk janë të mjaftueshme për të aktivizuar nenin 6 paragrafi 1 (shih rastet e GJEDNJ-së *Denisov kundër Ukrainës*, paragrafi 44; *Regner kundër Republikës Çeke*, paragrafi 99; *Károly Nagy kundër Hungarisë*, paragrafi 60; *Naït-Liman kundër Zvicrës*, paragrafi 106, *Benthem kundër Holandës*, nr. 8848/80, i 23 tetorit 1985).

112. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka zhvilluar dy konteste civile, njëri prej të cilëve ka të bëjë me përcaktimin e të drejtave të tij civile. Ky kontest përfundoi me aktgjykimin përfundimtar C1. nr. 190/07 të Gjykatës Themelore, i cili është në favor të parashtruesit të kërkesës, me ç'rast edhe u përcaktuan të drejtat e tij civile.

113. Kontesti i dytë u iniciua nga parashtruesi i kërkesës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme me qëllim të realizimit, përkatësisht ekzekutimit të të drejtave civile të cilat ai i realizoi me aktgjykimin e formës së prerë C1. nr. 190/07 të Gjykatës Themelore. Ky kontest përfundoi me aktgjykimin e formës së prerë të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së AC-I-18-0184, i cili mori formën e ekzekutueshme, dhe me këtë u konkretizuan***, a)*** *të drejtat civile të parashtruesit të kërkesës të cilat duhet të ekzekutohen*, dhe ***b)*** *autoriteti i cili është kompetent për të realizuar të drejtat e fituara civile të parashtruesit të kërkesës*.

114. Prandaj, për Gjykatën nuk është kontestues fakti që parashtruesi i kërkesës ka një aktgjykim përfundimtar dhe të ekzekutueshëm, të cilin Agjencia e Privatizimit, si autoritet kompetent, duhet ta ekzekutojë, dhe atë *"sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit"*, siç është përcaktuar me Aktgjykimin AC. -I-18-0184 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, prandaj mund të konkludohet që çështja është zgjidhur në favor të parashtruesit të kërkesës.

115. Duke pasur parasysh se Gjykata posa ka konstatuar se objekti i çështjes i parashtruesit është zgjidhur, Gjykata rikujton edhe praktikën e GjEDNj-së, të cilën ajo e zbaton në rastet kur konkludon që "*çështja është zgjidhur*". Në rastin konkret, Gjykata i referohet aktgjykimit të GjEDNj-së në rastin *Konstantin Markin kundër Rusisë*,

ku ajo në paragrafin 87 thekson: "*Gjykata përsërit se, sipas nenit 37 paragrafi 1 (b) të Konventës, ajo mund "në çdo fazë të procedimit, të vendosë të heqë nga lista e çështjeve një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin se ... çështja është zgjidhur. Për të qenë në gjendje të konkludojë që dispozita vlen për rastin e tanishëm, Gjykata duhet të përgjigjet në dy pyetje: së pari, duhet të kërkojë përgjigje në pyetjen nëse rrethanat, për të cilat paditësi ka paraqitur padi, ende ekzistojnë dhe, së dyti, a janë korrigjuar gjithashtu efektet e shkeljes së mundshme të Konventës mbi bazën e atyre rrethanave*" (shih aktgjykimet e GjEDNj-së *Konstantin Markin kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 30078/06 e 22 marsit 2012, paragrafi 87, *Keftailova kundër Letonisë* (heqje nga lista) [DhM] nr. 59643/00, paragrafi 48, 7 dhjetor 2007).

116. Megjithatë, në kontekstin e praktikës së lartpërmendur të GjEDNj-së, Gjykata vëren se një vendim të tillë ajo mund ta marrë vetëm me kushtin që paraprakisht të përgjigjet në dy pyetje, e të cilat janë *i) a ekzistojnë ende rrethanat, për të cilat paditësi ka paraqitur padi, dhe, ii) a janë korrigjuar gjithashtu efektet e shkeljes së mundshme të Konventës mbi bazën e atyre rrethanave?*

117. Duke u ndërlidhur me parimin e parë të praktikës së GjEDNj-së, përkitazi me pyetjen *i) a ekzistojnë ende rrethanat, për të cilat paditësi ka paraqitur padi,* Gjykata rikujton se thelbi i kërkesës së parashtruesit ishte shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së për faktin se aktgjykimin e Gjykatës Themelore i cili ka marrë formë të prerë, ai nuk ka mundur ta ekzekutojë. Megjithatë, Gjykata duke analizuar këtë pjesë të pretendimeve konkludoi se aktgjykimi i Gjykatës Themelore u bë plotësisht i ekzekutueshëm vetëm pas nxjerrjes së Aktgjykimit AC-I-18-0184 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së në procedurë përmbarimore, me ç'rast u përcaktuan të drejtat që duhet të ekzekutohen si dhe autoriteti kompetent i cili, duke përcjellë dinamikën e caktuar, edhe duhet ta ekzekutojë aktgjykimin në fjalë. Kësisoj mund të konkludohet që rrethanat përkitazi me ngritjen e pretendimeve ankimore për mosekzekutim të aktgjykimit në rrethanat në fjalë pushuan së ekzistuari, duke pasur parasysh se janë hequr të gjitha pengesat për ekzekutimin e aktgjykimit, me ç'rast është mundësuar që parashtruesi i kërkesës të realizojë të drejtat e përcaktuara me të.

118. Sa i përket përgjigjes në pyetjen e dytë *ii) a janë korrigjuar gjithashtu efektet e shkeljes së mundshme të Konventës mbi bazën e atyre rrethanave*, Gjykata, në këto rrethana të rastit konkret, mund vetëm të konstatojë që efektet e shkeljes së mundshme të Konventës, konkretisht të nenit 6 të KEDNj-së, janë korrigjuar me faktin se

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me nxjerrjen e Aktgjykimit AC-I-18-0184 ka ndryshuar rrethanat dhe ka mundësuar që një aktgjykim i plotfuqishëm të jetë edhe i ekzekutueshëm.

119. Nga sa u tha më lart, është evidente se Gjykata është përgjigjur në të dy pyetjet, dhe se përgjigjet në to, pa ekuivokë, çojnë në konkludimin se kemi të bëjmë me *çështje të zgjidhur*, dhe kësisoj sipas mendimit të Gjykatës, janë plotësuar kushtet që ajo të referohet si në praktikën e GjEDNj-së, ashtu edhe në rregullin 35 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, që përcakton:

> *"(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur Gjykata përcakton se pretendimi nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm, nuk paraqet një çështje të drejtë gjyqësore dhe nuk ka çështje të veçanta të të drejtave të njeriut të pranishme në rast (...)".*

120. Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit është pa objekt shqyrtimi, në rrethanat konkrete, duke qenë se Aktgjykimi AC-I-18-0184 i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së zgjidh në tërësi statusin e tij juridik në formë ekzekutive.

121. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se çështja e parashtruesit të kërkesës është vendosur në favor të tij dhe nuk ka më kontest të pazgjidhur, prandaj, objekti i çështjes së kërkesës nuk paraqet më rast apo kontest para Gjykatës (shih: *A.Y. kundër Sllovakisë*, vendim i GJEDNJ-së, paragrafi 49, nr. 37146/12 i 24 marsit 2016, shih gjithashtu rastin: KI143/15, parashtrues i kërkesës: *Donika Kadaj-Bujupi*, Gjykata Kushtetuese, vendim për hedhje poshtë të kërkesës, i 26 shkurtit 2016).

Përfundim

122. Prandaj, Gjykata konkludon:

i) që pjesa e kërkesës përkitazi me procedurën e iniciuar nga parashtruesi përmes kërkesës për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore, C1. nr. 686/2009, është e papranueshme, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike, siç përcaktohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, siç parashihet me nenin 47 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës;

ii) që pjesa e kërkesës përkitazi me përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore C1. nr. 190/07 është pa

objekt shqyrtimi dhe që, si e tillë, kjo pjesë e kërkesës hidhet poshtë, në pajtim me rregullin 35 (4) të Rregullores së punës, sepse të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta janë në favor të parashtruesit të kërkesës dhe ia njohin të drejtën për të cilën parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 35 (4) dhe 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 20 tetor 2021, me shumicë

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Radomir Laban	Gresa Caka Nimani

KI173/20, Parashtrues: Yusuf Timurhan, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev.nr.392/19, të 2 qershorit 2020

KI173/20, Aktvendim i 10 nëntorit 2021, publikuar më 01.12.2021

Fjalët kyçe: kompensim i shtesave në pagë, suspendim me pagesë nga puna, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, parashkrim, revizion

Nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesi i kërkesës, pjesëtar i Policisë së Kosovës, ishte suspenduar nga puna me pagesë të plotë si rezultat i ngritjes së Aktakuzës nga Prokuroria Komunale në Prizren për shkak të veprës penale *"Moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryerësve të veprave penale"* nga neni 304 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës. Gjatë kohës që kishte qenë i suspenduar, parashtruesi i kërkesës nuk kishte pranuar shtesat në pagë. Pas Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren për pushimin e procedurës penale kundër parashtruesit të kërkesës, ky i fundit u rikthye në vendin e punës dhe dorëzoi kërkesë për kompensimin e shtesave në pagë për periudhën gjatë së cilës kishte qenë i suspenduar. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës u refuzua me arsyetimin se me Vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës ishte përcaktuar që policët e suspenduar me pagesë nuk gëzojnë shtesa tjera përveç pagës bazë. Kundër këtij vendimi, parashtruesi paraqiti ankesë pranë Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime të Policisë së Kosovës, ankesë kjo e cila u hodh poshtë me arsyetimin se ishte paraqitur jashtë afatit ligjor, përkatësisht 4 muaj me vonesë. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi kundër Policisë së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme-Qeverisë së Kosovës në Gjykatën Themelore në Prizren, duke kërkuar që t'ia kompensojnë dhe paguajnë të gjitha ndalesat në të ardhurat personale në kohën e suspendimit, përkatësisht shtesat mbi pagën bazë. Gjykata Themelore aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke obliguar të paditurin që t'ia kompensojë dhe paguajë diferencën në të ardhura personale për periudhën e suspendimit, në lartësi prej 3,303.58 euro, me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 675.40 euro. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u vërtetua nga Gjykata e Apelit. Sidoqoftë, Gjykata Supreme, duke vendosur për revizionin e të paditurës, e pranoi si të bazuar revizionin, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore dhe refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e diferencës në të ardhurat personale, pasi gjeti se parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar mbrojtje gjyqësore jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 87 të Ligjit të Punës.

Parashtruesi i kërkesës, si pretendim kryesor para Gjykatës Kushtetuese kishte ngritur shkeljen e të drejtës për një gjykim të drejtë e të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, duke u fokusuar në vërtetim të gabuar

të gjendjes faktike dhe interpretim të gabuar të ligjit, për faktin se (i) nuk e kishte pranuar kërkesën për revizion që ishte parashtruar nga e paditura; (ii) revizioni nuk ishte i lejuar në rastin e tij; dhe (iii) Gjykata Supreme kishte ngritur vetë çështjen e parashkrimit pa u thirrur e paditura në të. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendonte gjithashtu shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, duke theksuar se vendimi i Gjykatës Supreme në mënyrë "arbitrare" kishte shkelur të drejtat e tij individuale.

Në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e praktikës së saj gjyqësore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me doktrinën e shkallës së katërt dhe më pas aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata e cilësoi si pretendim të pabazuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me mospranimin e kërkesës për revizion që ishte parashtruar nga e paditura, meqenëse pranimi i saj vërtetohej nga fletëkthesa. Ndërkaq, pretendimin e parashtruesit të kërkesës se revizioni ishte i palejuar meqenëse vlera e kontestit sipas padisë ishte 500 euro, Gjykata e vlerësoi si të pabazuar duke iu referuar nenit 212 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, pasi gjeti se vlera e kontestit ishte 3,303.58 euro, me ç'rast plotësohet kushti i shumës mbi 3,000 euro të kontestit, për të paraqitur revizion. Tutje, lidhur me pretendimin se Gjykata Supreme kishte vendosur për refuzim të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës për shkak të parashkrimit, pa e ngritur pala e interesuar, Gjykata gjeti se çështja e afatit ligjor për të kërkuar mbrojtje gjyqësore ishte ngritur edhe para gjykatave të shkallës më të ulët dhe se në rastin konkret, siç është konstatuar nga Gjykata Supreme, mbrojtja gjyqësore nga parashtruesi i kërkesë ishte parashtruar jashtë afatit ligjor. Përfundimisht, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata konkludoi se i takojnë kategorisë së pretendimeve të *"shkallës së katërt"*, rrjedhimisht, pretendime qartazi të pabazuara. Në anën tjetër, pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, Gjykata e cilësoi si të pabazuar, për faktin se i takon kategorisë së pretendimeve *"të pambështetura ose të paarsyetuara"*, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka shtjelluar se si ka ardhur deri te shkelja e kësaj të drejte.

Rrjedhimisht, Gjykata vendosi se kërkesa në tërësi duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI173/20

Parashtrues

Yusuf Timurhan

Vlerësim i kushtetutshmërisë ës Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.392/19, të 2 qershorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Yusuf Timurhan nga Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson avokati Miftar Qelaj nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 392/19] e 2 qershorit 2020, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.3309/16] e 3 korrikut 2019, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr.329/15] e 8 qershorit 2016, të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore).

3. Aktgjykimin e kontestuar parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar me 10 korrik 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin në vijim: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale), të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 10 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përmes e-mailit kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata).

7. Më 17 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani (anëtare).

8. Më 1 dhjetor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 1 dhjetor 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i dërgoi një kopje të kërkesës.

10. Më 15 prill 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të dorëzojë fletëkthesën, e cila dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar.

11. Më 29 prill 2021, Gjykata Themelore e dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën, që dëshmonte se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 10 korrik 2020.

12. Më 29 prill 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore dorëzimin e dosjes së plotë.

13. Më 12 maj 2021, Gjykata Themelore e dorëzoi dosjen në Gjykatë.

14. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi në përbërjen e Kolegjit shqyrtues gjyqtarin Nexhmi Rexhepi në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu i cili ka dhënë dorëheqje me 25 maj 2021.

15. Më 4 qershor 2021, Gjykata njoftoi Avokaturën Shtetërore, Qeverinë e Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës në cilësi të palës së interesuar, për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i dërgoi një kopje të kërkesës.

16. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

17. Më 22 korrik 2021, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe me shumicë rekomandoi plotësimin e rastit.

18. Më 10 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Më 15 maj 2009, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, përmes Vendimit [11/SP/DP/2009], përcaktoi që policët e suspenduar me pagesë nuk gëzojnë të drejtën në shtesa tjera përveç pagës bazë.

20. Më 22 gusht 2009, Policia e Kosovës përmes Njoftimit [KRH-02-086/09] suspendoi parashtruesin e kërkesës i cili ishte polic në Policinë e Kosovës, me pagesë të plotë. Suspendimi i parashtruesit zgjati deri më 15 maj 2011.

21. Nga shkresat e lëndës rezulton që Prokuroria Komunale kishte paraqitur aktin akuzues [PP.nr. 874/12] të 28 dhjetorit 2009, kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale moslajmërimi i

veprave penale apo moslajmërimi i kryerësve të veprave penale nga neni 304 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës.

22. Më 3 maj 2011, Policia e Kosovës përmes Njoftimit [09/NSP/DP/2011] e ndërpreu suspendimin me pagesë të parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se ishte vërtetuar se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm për vepër penale, prandaj kërkon nga ai paraqitjen në vendin e punës duke filluar nga 16 maji 2011.

23. Nga shkresat e lëndës rezulton që gjatë periudhës së suspendimit me pagesë, parashtruesi i kërkesës kishte pasur disa ndalesa në të ardhura personale ku përfshiheshin pagesa në emër të rrezikshmërisë, shtesat, si dhe kompensimi i pushimit vjetor.

24. Më 14 qershor 2012, Gjykata Komunale në Prizren përmes Aktvendimit [P.nr. 554/11] pushoi procedurën penale kundër parashtruesit të kërkesës lidhur me veprën penale moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryerësve të veprave penale nga neni 304 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës, pas tërheqjes së Prokurorisë nga ndjekja penale.

25. Më 20 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar në Drejtorinë e Personelit të Policisë së Kosovës kërkesë për kompensim të shtesave në pagë nga 22 gushti 2009 e deri me 15 maj 2011, lidhur me periudhën kohore të suspendimit me pagesë sipas vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.

26. Më 22 shtator 2014, Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës përmes *"përgjigjes në kërkesë e datës 20.02.2014"* [07/1/421/20147], refuzoi kërkesën e parashtruesit me arsyetimin se ndalesat për shtesat në pagë janë bërë sipas vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës [11/SP/DP/2009] të 15 majit 2009, ku theksohej që të gjithë policët e suspenduar me pagesë, nuk gëzojnë shtesa tjera përveç pagës bazë.

27. Më 11 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Shpërblime në Policinë e Kosovës duke kërkuar aprovimin e pagesës së të gjitha benificioneve gjatë kohës së suspendimit me pagesë. I njëjti theksonte që kjo e drejtë i takonte pasi me Aktvendimin [P.nr.554/11] e 14 qershorit 2012, të Gjykatës Komunale në Prizren, ishte pushuar procedura penale ndaj tij dhe rrjedhimisht ishte shpallur i pafajshëm.

28. Më 26 shkurt 2015, Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime i Policisë së Kosovës përmes Vendimit [010-KA-A-2015] hodhi poshtë ankesën

e parashtruar jashtë afatit ligjor nga ana e parashtruesit të kërkesës.. Në arsyetimin e Vendimit, Komisioni për ankesa dhe shpërblime i Policisë së Kosovës theksoi që parashtruesi i kërkesës me 22 shtator 2014, kishte pranuar përgjigjen nga Drejtoria e Personelit, kurse ankesën ndaj përgjigjes e ka adresuar në Komisionin për Ankesa dhe Shpërblime më 11 shkurt 2015, përafërsisht katër muaj me vonesë, në kundërshtim me nenin 96, paragraf 1, pika 1.2, të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2012 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ku theksohet: *"Personeli i Policisë i cili konsideron se me vendimin administrativ i është shkelur ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e punës, ka të drejtë të paraqes ankesë në organin e shkallës së dytë e cila i dërgohet drejtpërdrejtë Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime apo përmes zinxhirit komandues brenda afatit prej 15 ditësh".*

29. Më 20 mars 2015, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prizren (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore) ndaj të padituës Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, duke theksuar se i njëjti kërkon që t'ia kompensojnë dhe paguajnë të gjitha ndalesat në të ardhura personale në kohën e suspendimit, përkatësisht që nga 22 gushti 2009 deri me 15 maj 2011 dhe atë të ardhurat në emër të të ardhurave shtesë mbi pagën bazë.

30. Më 27 mars 2015, Policia e Kosovës dorëzoi përgjigjen në padi përmes së cilës kërkonte nga Gjykata Themelore që e njëjta ta mohonte si të palejuar padinë e parashtruesit të kërkesës, sepse i njëjti kishte kërkuar mbrojtje gjyqësore pas kalimit të afatit ligjor.

31. Më 8 qershor 2016, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.329/15] (i) aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, dhe obligoi Qeverinë e Kosovës, Ministrinë e Punëve të Brendshme - Policinë e Kosovës, që t'ia kompensojë dhe paguajë diferencën në të ardhura personale për periudhën 22 gusht 2009 deri me 15 maj 2011, në lartësi prej 3,303.58 euro, me kamatë ligjore si për mjetet e afatizuara mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar prej ditës se marrjes së këtij aktgjykimi, e deri te pagesa definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi; (ii) Obligoi të padituën që t'ia paguajë shpenzimet procedurale parashtruesit të kërkesës dhe atë në lartësi prej 675.40 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë; (iii) Refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, mbi shumat e aprovuara si në pikën I të dispozitivit, e deri në shumën e përgjithshme të kërkuar prej 4,523.35 euro.

32. Më 15 gusht 2016, Avokatura Shtetërore e cila përfaqësonte Policinë e Kosovës në cilësi të palës së interesuar, parashtroi ankesë për shkak të (i) shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin e ndryshimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke e hedhur poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të palejuar.

33. Më 3 korrik 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.3309/16] refuzoi si të pathemeltë ankesën e palës së interesuar: Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.329/15] e Gjykatës Themelore.

34. Më 28 gusht 2019, pala e interesuar- Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, parashtroi kërkesë për revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të: (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore; dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit të ndryshohen, ashtu që padia e parashtruesit të kërkesës të hidhej si e palejuar. Në kërkesë për revizion pala e interesuar theksonte që parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar mbrojtje gjyqësore pas afatit ligjor, përkatësisht i njëjti kishte parashtruar ankesë kundër përgjigjes në kërkesë [07/1/421/20147] të 22 shtator 2014, të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës, më 11 shkurt 2015, pra diku rreth katër (4) muaj me vonesë.

35. Më 16 tetor 2019, nga shkresat e lëndës përkatësisht fletëkthesa, rezulton që parashtruesi i kërkesës kishte pranuar kërkesën për revizion të parashtruar nga pala e interesuar. Parashtruesi i kërkesës nuk parashtroi përgjigje në kërkesën për revizion.

36. Më 2 qershor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.392/19] pranoi si të bazuar revizionin e palës së interesuar, Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C.nr.329/2015] të 8 qershorit 2016 dhe aktgjykimin [AC.nr.3309/2016] e 3 korrikut 2019, të Gjykatës së Apelit, duke gjykuar si vijon: Refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me të cilën është kërkuar që të detyrohet pala e interesuar, Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, që parashtruesit të kërkesës t'ia paguaj diferencën në të ardhura personale, për periudhën prej 22 gushtit 2009 e deri më 15

maj 2011, në lartësi prej 3,303.58€, me kamatë si për mjetet e deponuara në kursim, të afatizuara për më tepër se një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit (8 qershor 2016) e deri te pagesa definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 675.40€; secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

37. Në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme arsyeton si në vijim:

"Sipas kësaj Gjykate, gabimisht është zbatuar e drejta materiale dhe konkretisht Ligji i Punës, për faktin se paditësi është suspenduar më 22 gusht 2009 dhe ky suspendim ka zgjatë deri me 15 maj 2011, kur e paditura e ndërprenë suspendimin e paditësit dhe e kthen në punët dhe detyrat e mëparshme, ndërsa ka ushtruar padi me 20 mars 2015. Mbrojtja gjyqësore në rastin konkret është e pasafateshme për shkaqet qe lidhen me nenin 87 te Ligjit të Punës nr. 03/L-212, ku është paraparë se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, çka do të thotë se në rastin konkret ka kaluar afati i paraparë me nenin e cekur më lartë, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulet në mënyrë të gabuar kanë zbatuar dispozitat e nenit 78 par.1 e 2 dhe nenit 79 të Ligjit të Punës së Kosovës që kanë të bëjnë me mbrojtjen gjyqësore nga marrëdhënia e punës. Prandaj edhe udhëzimi juridik i dhënë në përfundim të procedurës pranë të padituës, është i gabuar dhe nuk e arsyeton vonesën e paditësit. Në nenin 87 të Ligjit të Punës parashihet qe kërkesat ne para qe lidhen me marrëdhënien e punës parashkruhen në afat prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës. Në rastin konkret prej momentit që paditësi u kthyer në punë e deri në ditën e paraqitjes se padisë kanë kaluar më tepër se 3 vjet, andaj rezulton se kërkesa e paditësit për kompensim të ardhurave personale është parashkruar."

"Gjykata Supreme nuk e pranon si të ligjshëm qëndrimin e të dy gjykatave për shkak se duke konsideruar se mospagesa e të ardhurave personale është fitim i humbur, i cili paraqet edhe dëm të shkaktuar paditësit nga ana e të padituës, vlerëson se kërkesa e tillë e paditësit është parashkruar duke u bazuar në dispozitën e nenit 376 par. 1 të LMD-së që parashihet se "Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin". Në rastin konkret prej ditës së suspendimit me 20 gusht 2009 e deri më 20 mars 2015 kur paditësi ka paraqitur padi në gjykatë kanë kaluar mbi pesë vjet dhe prej asaj kohe paditësi e

ka ditur për dëmin dhe për shkaktarin. Kështu mbi këtë bazë kërkesa është parashkruar dhe mbrojtja gjyqësore është e vonuar, sepse paditësi ka pas mundësi të kërkojë mbrojtje gjyqësore pavarësisht vonesave në përgjigje të kërkesës së tij."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, [Rev.nr.392/19] i 2 qershorit 2020, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

39. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se: (i) nuk është njoftuar për zhvillimin e procedurës në Gjykatën Supreme të Kosovës, rrjedhimisht atij nuk i është mundësuar të paraqes pretendimet dhe kundërshtimet në lidhje me kërkesën për revizionin të parashtruar nga pala e interesuar.

40. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendon që: (ii) në këtë rast është shqyrtuar revizioni edhe pse me ligj ka qenë i ndaluar në bazë të nenit 211 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sepse vlera e kontestit sipas padisë ishte 500 euro, ndërsa kontesti nuk ishte filluar kundër vendimit për shuarjen mbi marrëdhënien e punës, prandaj në këtë rast revizioni nuk ka qenë i lejuar.

41. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që Gjykata Supreme ka vendosur për refuzimin e padisë (iii) për shkak të parashkrimit të kërkesës, mirëpo për këtë pala e interesuar nuk ishte thirrur në përgjigje në padi gjatë tërë procedurës së shkallës së parë dhe as në ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Pra, më tej ai pretendon se nuk kishte njohuri se çka përmbante kërkesa për revizion e parashtruar nga pala e interesuar, pasi që sipas tij të njëjtën nuk e posedonte, si rezultat i mosdorëzimit. Përkundër kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson se bazuar në dispozitat e ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, përkatësisht neni 341 paragrafi 3 *"Gjykata nuk mund të marrë parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë."* Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se në asnjë rast në procedurën gjyqësore që ka paraprirë nxjerrjen e aktgjykimit të kontestuar, pala e interesuar nuk është thirrur në parashkrim, rrjedhimisht gjykata ka vendosur lidhur me parashkrimin pa e ngritur këtë çështje pala e interesuar.

42. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të (i) shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se Gjykata

Supreme e Kosovës me Aktgjykimin [Rev.nr.392/19] të 2 qershorit 2020, ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 54 (Mbrojtja gjyqësore e të drejtave) të Kushtetutës; si dhe (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Rev.nr.392/19] e 2 qershorit 2020, të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

[...]

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj

[...]

Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale

në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
(...)

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

KREU XIV
MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES

REVIZIONI

Neni 211

211.1 Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi.

211.2 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro.

211.3 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro.

211.4 Përjashtimisht edhe kur është fjala për kërkesëpadinë nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, revizioni gjithmonë është i lejuar:

a) në kontestet për ushqim;

b) në kontestet për shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur, për shkak të vdekjes së dhënësit të ushqimit;

c) në kontestet nga marrëdhëniet e punës të cilat i fillon i punësuari kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës.

Ligji Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve 1978

KAPTINA 4
PARASHKRIMI
Kaptina 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Rregulla e përgjthshme

Neni 360

Me parashkrimin pushon e drejta e kërkimit të përmbushjes se detyrimit.

Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit.

Gjykata nuk mund të përfillë parashkrimin në qoftë se debitori nuk e ka invokuar atë.

Kërkesa e shpërblimit të dëmit
Neni 376

Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin.

Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi.

Kërkesa e shpërblimit të dëmit të krijuar nga cenimi i detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e këtij detyrimi.

Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (publikuar më 19.06.2012 dhe hyn në fuqi më 19.12.2012)

KREU 4
PARASHKRIMI

NËNKREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 341
Rregullat e përgjithshme

1. Me parashkrim shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit.

2. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit.

3. Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë.

Ngritja e padisë

Neni 388

Parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës.

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

KREU IX
Proceduarat për Realizimin e të drejtave nga Marrëdhënia e Punës

Neni 78
Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit

1. I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.

2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës.

3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh.

Neni 79
Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë

Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Neni 87
Afati i parashkrimit

Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

43. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

44. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

45. Gjykata më tej i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç specifikohen në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet), të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]."

46. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.392/19] e 2 qershorit 2020, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me Ligj. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

47. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

"Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk

dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

48. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

49. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *"të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*". (Shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkese të vlerësuar si "*qartazi të pabazuar*", dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si "*qartazi të pabazuara*", Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 28 shkurtit 2021; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 279 deri më 308).

50. Në këtë kontekst, dhe në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në rrethanat e këtij rasti, vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

51. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të

Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

52. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit ndërlidhen me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e shtesave në pagë për periudhën sa ishte i suspenduar (nga 22 gushti 2009 deri më 15 maj 2011) drejtuar Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës, pasi që Prokuroria ishte tërhequr nga ndjekja penale dhe Gjykata Komunale përmes Aktvendimit kishte pushuar procedurën ndaj tij. Këtë kërkesë të parashtruesit, më 22 shtator 2014, e refuzoi Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës. Në vijim, më 15 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Shpërblime në Policinë e Kosovës, ankesë të cilën ky Komision e hodhi poshtë nën arsyetimin se e njëjta ishte parashtruar jashtë afatit ligjor. Në vijim, Gjykata Themelore e kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër palës së interesuar, përkatësisht Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policisë së Kosovës, që t'ia kompensojë dhe paguajë diferencën në të ardhura personale për periudhën 22 gusht 2009 deri me 15 maj 2011, në lartësi prej 3,303.58 euro, me kamatë ligjore si për mjetet e afatizuara mbi një vit pa destinim të caktuar. Duke vepruar sipas ankesës përkatëse të palës së interesuar, Gjykata e Apelit, refuzoi si të pathemeltë ankesën e saj, ndërsa vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, pala e interesuar kishte parashtruar kërkesë për revizion, e cila nga Gjykata Supreme pranohet si e bazuar, si dhe ndryshohen Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, duke gjykuar si vijon: Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës, me të cilën ishte kërkuar që të detyrohej pala e interesuar, Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, që atij t'ia paguaj diferencën në të ardhura personale, për periudhën prej 22 gushtit 2009 e deri më 15 maj 2011, në lartësi prej 3,303.58€.

53. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës pretendon se përmes Vendimit të kontestuar i shkelen të drejtat e tij të garantuara me: (i) nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejt dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së; si dhe pretendimet për shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

I) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

54. Parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës ka ngritur tri pretendime kryesore lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës: (i) se nuk e ka pranuar kërkesën për revizion të parashtruar nga pala e interesuar, rrjedhimisht nuk kishte mundësi që të paraqiste kundërshtimet e tij lidhur me përmbajtjen e kësaj kërkese; (ii) revizioni nuk ishte i lejuar në këtë rast në bazë të nenit 211 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sepse vlera e kontestit sipas padisë ishte 500 euro, ndërsa kontesti nuk ishte filluar kundër vendimit për shuarjen mbi marrëdhënien e punës; dhe (iii) pretendimi që Gjykata Supreme ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së tij për shkak të parashkrimit të kërkesës, pa e ngritur këtë çështje pala e interesuar.

55. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis "*kushtetutshmërisë*" dhe "*ligjshmërisë*" dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih në këtë kontekst rastet e Gjykatës KI128/18, Parashtrues: *Limak Kosovo International Airport J.S.C.*., "*Adem Jashari*", Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).

56. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih: në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura atje; dhe shih gjithashtu rastet KI128/18, të cituara më sipër, paragrafi 56; dhe KI62/19, të cituar më lart, para 58).

57. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjeve të zbatueshme nga Gjykata Supreme. Gjykata vëren se Gjykata Supreme arsyeton në mënyrë të detajuar se në bazë të cilave

prova dhe në bazë të të cilave dispozita materiale ka nxjerrë aktgjykimin përkatës, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

(i) **Lidhur me pretendimin e mospranimit të kërkesës për revizion të *parashtruar nga pala e interesuar***

58. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është njoftuar për zhvillimin e procedurës në Gjykatën Supreme të Kosovës, rrjedhimisht atij nuk i është mundësuar të paraqesë pretendimet dhe kundërshtimet në lidhje me kërkesën për revizionin e parashtruar nga pala e interesuar.

59. Lidhur me pretendimin e lartcekur, Gjykata vëren se në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme është theksuar se nuk pati përgjigje në revizion. Për më tepër, Gjykata thekson se në dosje të lëndës ekziston fletëkthesa e cila dëshmon që kërkesa për revizion është pranuar nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, më 16 tetor 2019.

60. Rrjedhimisht, përderisa parashtruesi i kërkesës e ka pranuar në mënyrë të rregullt revizionin, i njëjti nuk e shfrytëzoi të drejtën e tij që të parashtronte përgjigje në revizion para Gjykatës Supreme, prandaj ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është qartazi i pabazuar.

(ii) **Lidhur me pretendimin se revizioni nuk ishte i lejuar në rastin konkret**

61. Gjykata në vijim rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendonte që në rastin konkret është shqyrtuar revizioni edhe pse me ligj ka qenë i ndaluar në bazë të nenit 211 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sepse vlera e kontestit sipas padisë ishte 500 euro, ndërsa kontesti nuk ishte filluar kundër vendimit për shuarjen mbi marrëdhënien e punës, prandaj në këtë rast sipas tij revizioni nuk ka qenë i lejuar.

62. Në vijim, lidhur me pretendimin lartcekur të parashtruesit të kërkesës, Gjykata thekson që paragrafi 2 i nenit 211 të Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton që: "*Revizion nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro*".

63. Rrjedhimisht, në rastin konkret Gjykata vëren se revizioni i parashtruar nga pala e interesuar u ushtrua në procedurën në të cilin

vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të Aktgjykimit, ishte shuma 3,303.58 euro. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson që kufiri minimal i kërkuar nga kjo dispozitë ligjore është përmbushur. Prandaj, ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është po ashtu qartazi i pabazuar.

(iii)* Lidhur me pretendimin se *Gjykata Supreme ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë për shkak të parashkrimit të kërkesës, pa e ngritur këtë çështje pala e interesuar

64. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që Gjykata Supreme ka vendosur për pranimin e revizionit të palës së interesuar, me ç' rast ka rezultuar me refuzimin e kërkesëpadisë së tij për shkak të parashkrimit të kërkesës, mirëpo për këtë pala e interesuar nuk ishte thirrur në përgjigje në padi gjatë tërë procedurës së shkallës së parë dhe as në ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Pra, më tej ai pretendon se nuk kishte njohuri se çka përmbante kërkesa për revizion e parashtruar nga pala e interesuar, pasi që sipas tij të njëjtën nuk e posedonte, si rezultat i pretendimit të tij se e njëjta nuk i ishte dorëzuar.

65. Lidhur me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht rikujton që çështja e parashkrimit ishte trajtuar nga gjykatat e rregullta që nga marrja e Aktgjykimit [C.nr.329/15] të Gjykatës Themelore, e cila në arsyetimin e saj theksonte:

"Po ashtu edhe në nenin 87 të ligjit të punës është e paraparë se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, e që sipas, vlerësimit të gjykatës kërkesa e paditësit ka qenë e parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë sipas kësaj dispozite andaj dhe vendosi si në dispozitiv."

66. Gjykata vëren se në kërkesën për revizion të Avokaturës Shtetërore, e njëjta kërkonte nga Gjykata Supreme që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e palejuar me ligj: pasi që përmes saj parashtruesi i kërkesës kërkonte mbrojtje gjyqësore pas kalimit të afatit të paraparë ligjor, brenda të cilit kishte mundur të kërkonte mbrojtje gjyqësore.

67. Gjithashtu, Gjykata rikujton nenin 341 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve që përcakton se *"gjykata nuk mund të marrë parasysh parashkrimin kur debitori nuk thirret në të"*. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se në kërkesën për revizion të Avokaturës Shtetërore, kjo e fundit nuk ishte thirrur në refuzim të kërkesëpadisë

të parashtruesit mbi bazën e parashkrimit, por megjithatë kishte ngritur specifikisht çështjen e mbrojtjes gjyqësore pas kalimit të afatit të paraparë ligjor.

68. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.392/19] të 2 qershorit 2020, pranoi si të bazuar revizionin e të padituës duke konstatuar se gabimisht ishte zbatuar e drejta materiale nga gjykatat e shkallës më të ulët, pasi që parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur mbrojtje gjyqësore jashtë afatit ligjor. Ndër tjerash, Gjykata Supreme theksoi si në vijim arsyet e pranimit të revizionit:

> *"Sipas kësaj Gjykate, gabimisht është zbatuar e drejta materiale dhe konkretisht Ligji i Punës, për faktin se paditësi është suspenduar më 22 gusht 2009 dhe ky suspendim ka zgjatë deri me 15 maj 2011, kur e paditura e ndërprenë suspendimin e paditësit dhe e kthen në punët dhe detyrat e mëparshme, ndërsa ka ushtruar padi me 20 mars 2015. Mbrojtja gjyqësore në rastin konkret është e pasafateshme për shkaqet qe lidhen me nenin 87 te Ligjit të Punës nr. 03/L-212, ku është paraparë se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, çka do të thotë se në rastin konkret ka kaluar afati i paraparë me nenin e cekur më lartë, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulet në mënyrë të gabuar kanë zbatuar dispozitat e nenit 78 par.1 e 2 dhe nenit 79 të Ligjit të Punës së Kosovës që kanë të bëjnë me mbrojtjen gjyqësore nga marrëdhënia e punës. Prandaj edhe udhëzimi juridik i dhënë në përfundim të procedurës pranë të padituës, është i gabuar dhe nuk e arsyeton vonesën e paditësit. Në nenin 87 të Ligjit të Punës parashihet qe kërkesat ne para qe lidhen me marrëdhënien e punës parashkruhen në afat prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës. Në rastin konkret prej momentit që paditësi u kthyer në punë e deri në ditën e paraqitjes se padisë kanë kaluar më tepër se 3 vjet, andaj rezulton se kërkesa e paditësit për kompensim të ardhurave personale është parashkruar."*

69. Prandaj, duke marrë për bazë të lartcekurat, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se

arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih: *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, i cituar më lart, paragrafi 58).

70. Gjykata thekson që në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit, për shkak se gjykatat e rregullta kanë zbatuar ligjin "*në dëm të këtij parashtruesi të kërkesës"*, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë "*qartazi i gabuar*", duke rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin e kërkesës, apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar qartazi të njëjtat (Shih: në këtë drejtim, rastin e Gjykatës KI64/20, parashtrues: *Asllan Meka,* Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41 dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).

71. Përfundimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të interpretimit të gabuar dhe aplikimit të gabuar të ligjit të zbatueshëm janë (i) pretendime që bien në kategorinë e "*shkallës së katërt*" dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

72. Prandaj, këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe shpallen të papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

(II) Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës

73. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson që vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me të drejtat e

garantuara me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

74. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon që aktgjykimi i Gjykatës Supreme, *"në mënyrë arbitrare"* ka shkelur të drejtat e tij individuale dhe ka ardhur deri te shkelja e nenit 54 të Kushtetutës, mirëpo i njëjti, nuk shpjegon specifikisht se si ka ardhur deri te shkelja e këtij neni të Kushtetutës. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit,* Aktvendim për Papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KI04/21, me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 majit 2021, paragrafët 38- 39).

75. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse ky pretendim cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve *"të pambështetura ose të paarsyetuara"*, pasi parashtruesi i kërkesës thjesht ka cituar një dispozitë të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, pa shpjeguar se si është shkelur ajo. Prandaj, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

76. Në fund, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse (I) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës (i) se nuk e ka pranuar kërkesën për revizion të parashtruar nga pala e interesuar, rrjedhimisht nuk kishte mundësi që të paraqiste kundërshtimet e tij lidhur me përmbajtjen e kësaj kërkese; (ii) revizioni nuk ishte i lejuar në këtë rast në bazë të nenit 211 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sepse vlera e kontestit sipas padisë ishte 500 euro, ndërsa kontesti nuk ishte filluar kundër vendimit për shuarjen mbi marrëdhënien e punës; dhe (iii) pretendimi që Gjykata Supreme ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së tij për shkak të parashkrimit të kërkesës, pa e ngritur këtë çështje pala e interesuar; janë pretendime që kualifikohen si pretendime *"të shkallës së katërt"*; dhe

si të tilla këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; dhe (II) pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, është qartazi i pabazuar, sepse i njëjti cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve "*të pambështetura ose të paarsyetuara*". Prandaj, kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 nëntor 2021, njëzëri:

VENDOS

I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bajram Ljatifi	Gresa Caka Nimani

KI123/21, Parashtrues: Luan Telak, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 69/2021, të 18 marsit 2021

KI123/21, Aktvendim i 10 nëntorit 2021, publikuar më 3 dhjetor 2021

Fjalët kyç: ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor, shkeljet procedurale me ndikimin në aktgjykim, shpallje fajtor

Nga shkresat e lëndës rezulton që thelbi i rastit që ngërthen kjo kërkesë ndërlidhet me faktin që Gjykata Themelore në Prishtinë shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe personi F.K. për veprën penale *"blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273, paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPK-së"* pasi gjatë kontrollit rutinor në vendkalimin kufitar në Merdar, gjetën një sasi të caktuar të substancave narkotike që i përkisnin parashtruesit të kërkesës dhe F. K., në automjetin me markë "Peugeot 308" të cilin e drejtonte parashtruesi i kërkesës. Gjykata e Apelit duke vendosur sipas ankesave, aprovoi ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, duke e ndryshuar dënimin me burgim të shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj, ndërsa ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe F. K. e refuzoi si të pabazuar. Lidhur me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, mes tjerash, për shkak të shkeljeve esenciale nga neni 311 [Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues gjatë shtyrjes], paragrafi 3 të KPPK-së, sepse nga seanca e 27 majit 2019 e deri në seancën e radhës të 24 tetorit 2019 nuk është mbajtur asnjë seancë, e që kanë kaluar më shumë se 3 (tre) muaj, ashtu që gjykata është dashur të ketë parasysh këtë vonesë dhe shqyrtimin gjyqësor ta filloj rishtas, për faktin se kanë kaluar më tepër se 3 (tre) muaj nga seanca e fundit, ashtu siç parashihet me nenin 311 të KPPK-së. Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Pml. nr. 69/2021, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës, duke i mbështetur në tërësi aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore, duke arsyetuar se lëshimi procedural nuk përbënte shkelje esenciale të procedurës penale pasi nuk kishte ndikim në ligjshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

Parashtruesit të kërkesës pretendonte para Gjykatës Kushtetuese se atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Ai pretendoi se Gjykata Themelore ka ndërprerë shqyrtimin gjyqësor për më tepër se 3 (tre) muaj dhe përkundër dispozitës së KPPK-së, konkretisht nenit 311, paragrafi 3 që përcakton se nëse shqyrtimi

gjyqësor ndërpritet për më tepër se 3 (tre) muaj, duhet të filloj shqyrtimi i ri ku do të vlerësohen këto prova, Gjykata Themelore ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor dhe ka nxjerr Aktgjykim pa përfillur shqyrtimin gjyqësor.

Në trajtimin e pretendimit për shkelje procedurale të cilin pretendim ai e ndërlidh me të drejtën për një gjykim të drejtë, Gjykata fillimisht vuri thekson, mes tjerash, në qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç; nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata ritheksoj më tej se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt" në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Në të vërtetë është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Në trajtimin e pretendimeve të parashtruesit, Gjykata rikujtoi konstatimin e Gjykatës Supreme se këto pretendime binin në kategorinë e shkeljeve procedurale relative sipas paragrafit 2 të nenit 384 të KPPK-së. Andaj, në raste të tilla, shkelja procedurale do të ndikonte në ligjshmërinë e një vendimi të tillë, vetëm nëse do të kishte ndikim në vendimin të ligjshëm. Ndërsa sipas Gjykatës Supreme, ky lëshim procedural nuk kishte ndikim në ligjshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Në këtë konstatim, Gjykata Supreme erdhi duke vlerësuar edhe çështjen e keqinterpretimit të deklaratave dhe dëshmive që ishin shqyrtuar nga Gjykata Themelore, duke iu referuar edhe dëshmive që parashtruesi kishte dhënë para policisë në prani të mbrojtësit të tij dhe fakteve tjera. Andaj, Gjykata gjeti se lidhur me të drejtën për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës para gjykatave të rregullta i ka pasur përfitimet e procedurës kontradiktore; ai ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij, e ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare, gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje dhe se procedurat marrë në tërësinë e tyre ishin të drejta. Sa i përket shkeljeve të të drejtave të garantuara me nenet 3, 7, 46 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata gjeti se këto pretendime nuk janë qartësuar saktësisht dhe nuk janë paraqitur në mënyrë adekuate faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese

Rrjedhimisht, kërkesa në tërësi duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI123/21

Parashtrues

Luan Telaku

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 69/2021, të 18 marsit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Luan Telak, nga Prizreni i cili përfaqësohet nga Florent Latifaj, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 69/2021, të 18 marsit 2021, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 360/2020, të 26 tetorit 2020, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, PKR. nr. 235/2018, të 24 tetorit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me

nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

7. Më 27 korrik 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.

8. Më 10 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

9. Më 28 mars 2018, Policia e Kosovës dhe Shërbimi Doganor i Kosovës gjatë kontrollit rutinor në vendkalimin kufitar në Merdar, gjetën një sasi të caktuar të substancave narkotike që i përkisnin parashtruesit të kërkesës dhe F. K., në automjetin me markë “Peugeot 308” të cilin e drejtonte parashtruesi i kërkesës.

10. Më 19 shtator 2018, Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzën, PP/I. nr. 81/2018, para Gjykatës Themelore në Prishtinë, kundër parashtruesit të kërkesës dhe F. K., për shkak të dyshimit të bazuar se ata, si bashkëkryerës, kanë kryer veprën penale nga neni

273, paragrafi 2 [blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge] të Kodit Penal të Kosovës, nr. 04/L-082 (në tekstin e mëtejmë: KPK) lidhur me nenin 31 [Bashkëkryerja] të KPK-së".

11. Më 24 tetor 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë nxori Aktgjykimin PKR. nr. 235/18, me të cilin, parashtruesi i kërkesës dhe personi F. K. u shpallën fajtorë për veprën penale *"blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273, paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPK-së"* dhe u dënuan, secili me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, si dhe me dënimin me gjobë në shumë prej 5,000.00 euro si dhe dënimin plotësues, konfiskim i veturës "Peugeot 308", konfiskimin e një sasie të substancave narkotike dhe disa gjësende të tjera. Parashtruesi i kërkesës lidhur me veprën penale nga neni 273 i KPK-së kishte pranuar fajësinë, ndërsa nuk kishte pranuar fajësinë për vepër penale nga neni 31 [Bashkëkryerje] të KPK-së. Megjithatë, Gjykata Themelore nuk e ka aprovuar pranimin e fajësisë pasi pranimi ka qenë i pjesshëm.

12. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit të miratojë ankesën dhe parashtruesit të kërkesës, t' i shqiptoj dënim më të butë.

13. F. K. paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljeve të rënda të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

14. Prokurori i Apelit gjithashtu paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit të dënohen me dënime më të larta, ndërsa ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe F. K., të refuzohet si e pabazuar.

15. Më 26 tetor 2020, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PAKR. nr. 360/2020, me të cilin e aprovoi ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, duke e ndryshuar dënimin me burgim të shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj, ndërsa ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe F. K. e refuzoi si të pabazuar. Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se dënimi i shqiptuar nga Gjykata Themelore, është i butë dhe me atë nuk mund të arrihet qëllimi i shqiptimit të sanksionit penal në segmentin e preventivës individuale dhe asaj gjenerale dhe se

Gjykata Themelore nuk i kishte vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese të cilat janë evidente në rastin konkret. Andaj, vendosi që t' ju shqiptojë dënim më të ashpër të dënuarave. Në pjesën e arsyetimit të Aktgjykimit e cila i referohet ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Gjykata e Apelit theksoi:

> *" [...] në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk e merr parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale meqë të akuzuarit paraprakisht kanë përgatitur veturën për bartjen e narkotikëve në mënyrë që kanë shkuar në Serbi, ku edhe kanë qëndruar deri sa të modifikohet dhe përgatitet për fshehjen e narkotikut, por edhe sasia prej 26.855.34 gram që është gjetur e fshehur në pjesën e modifikuar të veturës në vendkalimin kufitar në Merdar (kufiri Kosovë-Serbi) që njëherë tregon shkallën e lartë të dashjes dhe vendosmërinë e tyre për të kryer veprën penale, ndërsa veprimet e tyre i bënë me rrezikshmëri të lartë shoqërore, si me të drejtë tërheq vërejtjen edhe Prokurori në ankesën e tij. Prandaj, në praninë e këtyre rrethanave rënduese, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i butë, për çka me të drejtë tërheqë vërejtjen Prokuroria në ankesën e tij. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si kryerës, dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të [Kodit të Procedurës Penale] KPPK".*

16. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 360/2020, të 26 tetorit 2020 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, PKR. 235/18, të 24 tetorit 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, mes tjerash, për shkak të shkeljeve shkelje esenciale nga neni 311 [Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues gjatë shtyrjes], paragrafi 3 të KPPK-së, sepse nga seanca e 27 majit 2019 e deri në seancën e radhës të 24 tetorit 2019 nuk është mbajtur asnjë seancë, e që kanë kaluar më shumë se 3 (tre) muaj, ashtu që gjykata është dashur të ketë parasysh këtë vonesë dhe shqyrtimin gjyqësor ta filloj rishtas, për faktin se kanë kaluar më tepër se 3 (tre) muaj nga seanca e fundit, ashtu siç parashihet me nenin 311 të KPPK-së.

17. Më 18 mars 2021, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Pml. nr. 69/2021, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës, duke i mbështetur në tërësi aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore. Në arsyetimin e

Aktgjykimit në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me mosmbajtjen e shqyrtimit të ri gjyqësor për shkak të kalimit të afatit më tepër se 3 (tre) muaj, Gjykata Supreme, theksoi se për këtë pretendim vlen arsyetimi i dhënë për të akuzuarin F. K., ku ishte theksuar se:

> *" [...] nga seanca e fundit gjyqësore, nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë vlerësoi se veprimi i këtillë i gjykatës paraqet shkelje relative të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par. 2 të KPPK-së, dhe ky veprim nuk ka pasur ndikim në marrjen e vendimit të ligjshëm dhe pretendimin nuk e aprovoji".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet e kontestuara janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 46 [Mbrojta e Pronës], dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

19. Parashtruesi i kërkesës thekson se si rezultat i shkeljeve procedurale të Gjykatës Themelore ku në paragrafin 3 të këtij neni, specifikohet se *"Kur shtyrja [e shqyrtimit gjyqësor] ka zgjatur më shumë se tre (3) muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat"*. Andaj, parashtruesi mban qëndrimin se në Gjykatën Themelore ka bërë shkelje esenciale të procedurës penale, që ka rezultuar edhe në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, pasi nga mbajtja e njërës seancë deri në tjetrën kanë kaluar më shumë se 3 (tre) muaj, respektivisht rezulton se gati 5 (pesë) muaj nuk është mbajtur seancë shqyrtuese. Si pasojë, kjo ndërprerje e procedurës penale një kohë të gjatë, ka sjellur deri tek lajthitja e fakteve kryesore në rastin konkret dhe me të drejtë ligjvënësi ka caktuar se pas një periudhe kohore, rasti duhet të filloj rishtazi. Për këtë arsye, që të mos vij deri tek konstatimi i gabuar i fakteve, KPPK ka paraparë qartë se nëse shtyrja e seancave zgjatë më tepër se 3 (tre) muaj, shqyrtimi gjyqësor fillon rishtazi. Andaj, edhe dënimi i tij është bërë mbi fakte të konstatuara në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me dispozitat procedurale.

20. Lidhur më këtë, parashtruesi i kërkesës ankohet para Gjykatës se Gjykata Themelore gjithashtu ka keqinterpretuar deklaratat e parashtruesit të kërkesës dhe F. K. sa i përket pronësisë së automjetit "Peugeot 308"; deklaratat rreth planifikimit të udhëtimit në Serbi; si dhe lidhur me atë nëse F. K. ka pasur dijeni për prezencën e

substancave narkotike në automjetin e drejtuar nga parashtruesi i kërkesës. Parashtruesi i kërkesës deklaron se ai nuk ka dhënë dëshmi ku ka deklaruar se F. K. ka pasur dijeni për substancat narkotike por ky i fundit vetëm ka shoqëruar parashtruesin e kërkesës në udhëtimin e tij për në Serbi. Ai shton se *"Në fakt e gjithë deklarata e Luan Telakut ka të bëjë me [personin E.] dhe [personin A.] [F.K.] vetëm në fund është parafrazuar në deklaratë ku ka konstatuar se e ka thirrur në mëngjes dhe e ka pyetur 'a vjen me mua në Serbi' ... me veturën e [personit E.] ku edhe ka qenë droga"*. Gjithashtu, ai thotë se deklarata tij ka qenë se në dijeni për "bunkerin" e drogës në veturë, i referohet personit E. dhe jo F. K.

21. Andaj, të gjitha këto keqinterpretime të deklaratave parashtruesi i kërkesës thekson se kanë rezultuar si pasojë e shkeljes procedurale të dispozitës së nenit 311 [Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues gjatë shtyrjes të KPPK-së], dhe të cilat rezultojnë në shkelje esenciale të procedurës penale nga neni 384 [Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale] i KPPK-së.

22. Rrjedhimisht, në kundërshtim me dispozitat procedurale, Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar si të vërtetuara faktet të cilat janë kundërthënëse dhe është bazuar në deklarata që janë keqinterpretuar dhe të cilat kanë dërguar tek përgjegjësia penale.

23. Andaj, ai i referohet vendimit të Gjykatës Supreme duke theksuar se konstatimi i kësaj të fundit se është i saktë pretendimi se ka ndodhur shtyrja e seancave gjyqësore për më tepër se 3 (tre) muaj, por se kjo shkelje nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Lidhur me këtë konstatim të Gjykatës Supreme, ai thekson se *"Gjykata Supreme është Gjykatë, që kontrollon ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta, në rastin konkret përkundrazi kjo Gjykatë po mbron paligjshmërinë [...]"*.

24. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i referohet dispozitave të KPPK-së që përcaktojnë se një shtyrje e shqyrtimit gjyqësor ka zgjatur më tepër se 3 (tre) muaj, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen provat. Andaj, ai përsërit se në rastin e tij, kemi shqyrtim gjyqësor *"pa seancë gjyqësore"* pasi neni 311 i KPPK-së detyron gjykatën që nëse shtyrja ka zgjatur më tepër se 3 (tre) muaj, shqyrtimi gjyqësor fillon nga e para.

25. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të vendosë si në vijim:

"I. APROVOHET si e bazuar Kërkesa për kushtetutshmëri e paraqitur nga parashtruesi Av. Florent Latifaj, me të dhënat si në hyrje të kësaj kërkese.

II. KONSTATOHET se të njëjtit me Aktgjykimin PKR. nr. 235/18, i marrë nga Gjykata Themelore e Prishtinës, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe si Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i është shkelur E drejta për Gjykim të drejtë dhe të paanshëm e paraparë në nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

III. KONSTATOHET se në ndërlidhje me pikën e II-të, janë shkelur edhe nenet 3, 7, 46 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

IV. SHPALLET I PAVLEFSHËM Aktgjykimi PKR. nr. 235/18, i marrë nga Gjykata Themelore e Prishtinës, i datës 24.10.2019, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR. nr. 360/2020 i datës 26.10.2020 dhe Aktgjykimi i marrë nga Gjykata Supreme e Kosovës Pml. nr. 69/2021 i datës 18.03.2021, dhe çështja i KTHEHET NË RISHQYRTIM Gjykatës Themelore në Prishtinë".

Dispozitat relevante kushtetuese e ligjore

Kushtetuta

"Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]
4.Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
[...]"

Kodit e Përkohshëm Penal të Kosovës

"Neni 31
Bashkëkryerja

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.
[...]

Neni 273
Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope

1.Kushdo që organizon, drejton apo financon ndonjë prej veprave penale nga ky Kapitull, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

2.Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin sasi të madhe të narkotikëve apo substancave psikotrope, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Neni 311
Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues gjatë shtyrjes

1. Kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë fillon rishtas. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërish në pyetje dhe të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklarimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbali i këqyrjes së vendit.
2. Kur përbërja e trupit gjykues nuk ka ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë vazhdohet para të njëjtit trup gjykues dhe kryetari i trupit gjykues shkurtimisht paraqet rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor të mëparshëm. Por, edhe në këtë rast, trupi gjykues mund të caktojë që shqyrtimi gjyqësor të fillojë rishtas.
3. Kur shtyrja ka zgjatur më shumë se tre (3) muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat.

[...]

Neni 384
Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

1. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse:

1.1. përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi;

1.2. në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet;

1.3. shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj, ose kur të akuzuarit apo mbrojtësit, pavarësisht nga kërkesa e tij, i është mohuar përdorimi i gjuhës së vet në shqyrtim gjyqësor dhe përcjellja e zbatimit të shqyrtimit gjyqësor në gjuhën e tij;

1.4. publiku është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor në kundërshtim me ligjin;

1.5. gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen nëse ekziston akuza e prokurorit të autorizuar, propozimi i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent;

1.6. aktgjykimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes.

1.7. gjykata me aktgjykim nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës;

1.8. aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme;

1.9. i akuzuari i thirrur të deklarohet mbi fajësinë nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezentimit të provave;

1.10. aktgjykimi ka tejkaluar akuzën;

1.11. me aktgjykim është shkelur dispozita e nenit 395 të këtij Kodi; ose

1.12. aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të këtij Kodi.

2. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës penale, duke përfshirë edhe procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia:

2. 1. nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht; ose

2.2. kanë shkelur të drejtat e mbrojtjes, dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

27. Gjykata vëren se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, Plm. nr. 69/2021, të 18 marsit 2021, është kontestuar edhe përmes kërkesës KI124/21, të cilën kërkesë Gjykata e trajton ndaras.

28. Në këtë drejtim, lidhur me rastin e tanishëm, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

29. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afati]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".

30. Për sa i përket përmbushjes së kritereve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; ka qartësuar aktin e autoritetit publik kushtetutshmërinë e të cilit e konteston, konkretisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 69/2021, të 18 marsit 2021; ka specifikuar të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar; si dhe ka dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor.

31. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës, përcakton që:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

32. Gjykata fillimisht vëren se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që t'i shpallë kërkesat të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KI04/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26, gjithashtu rastin KI175/21, parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

33. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "qartazi e pabazuar" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "pretendime qartazi të pabazuara". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "*të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*". (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkese të vlerësuar si "qartazi të pabazuar", dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si "qartazi të pabazuara", Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; Pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284, gjithashtu shih rastin KI04/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 38).

34. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KI04/21, cituar më lart, paragrafi 28, si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 39).

Lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së

35. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e rregullta kanë interpretuar KPPK-në, në rastin e tij. Lidhur me këtë, ai pretendon se Gjykata Themelore ka ndërprerë shqyrtimin gjyqësor për më tepër se 3 (tre) muaj dhe përkundër dispozitës së KPPK-së, konkretisht nenit 311, paragrafi 3 që përcakton se nëse shqyrtimi gjyqësor ndërpritet për më tepër se 3 (tre) muaj, duhet të filloj shqyrtimi i ri ku do të vlerësohen këto prova, Gjykata Themelore ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor dhe ka nxjerr

Aktgjykim pa përfillur shqyrtimin gjyqësor. Si rezultat i ndërprerjes së shqyrtimit gjyqësor ka ardhur deri te keqinterpretimi edhe i deklaratave të parashtruesit të kërkesës të dhëna në shqyrtimin gjyqësor gjë që ka ndikuar në dënimin ndaj parashtruesit të kërkesës. Kjo shkelje procedurale nuk është evituar as nga Gjykata e Apelit e as nga Gjykata Supreme. Në fakt, Gjykata Supreme edhe pse ka konstatuar se ka ndodhur një shkelje e tillë procedurale, ka deklaruar se kjo nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

36. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton fillimisht se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vendosur nëse një parashtrues ka qenë fajtor për kryerjen e veprës penale apo jo. Ajo nuk ka as juridiksion për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë apo për të vlerësuar nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë pasur dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës. (shih, në këtë kontekst dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues i kërkesës: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues i kërkesës: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues i kërkesës: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).

37. Gjykata vë theksin në qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç; nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata rithekson më tej se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt" në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Në të vërtetë është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNj-së *García Ruiz kundër Spanjës,* Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës KI128/18, i cituar më lart, paragrafi 56; dhe KI62/19, i cituar më lart, paragrafi 58).

38. Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese, mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të drejtë ose jo arbitrar (shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, miratuar më 10 korrik

1991 dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës KI110/19, cituar më lart, paragrafi 41).

39. Në vijim, Gjykata do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të saj dhe të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

40. Në raport me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren fillimisht se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Supreme kishte pretenduar se në rastin e tij kishte shkelje procedurale edhe pse shqyrtimi gjyqësor ishte ndërprerë për më tepër se 3 (tre) muaj, shqyrtimi gjyqësor nuk kishte filluar rishtas ashtu si kërkohet me nenin 311 të KPPK-së.

41. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me mosmbajtjen e shqyrtimit të ri gjyqësor për shkak të kalimit të afatit më tepër se 3 (tre) muaj, Gjykata Supreme, theksoi se për këtë pretendim vlen arsyetimi i dhënë për të akuzuarin F.K., ku ishte theksuar se:

> *" [...] nga seanca e fundit gjyqësore, nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë vlerësoj se veprimi i këtillë i gjykatës paraqet shkelje relative të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 të KPPK-së, dhe ky veprim nuk ka pas ndikim në marrjen e vendimit të ligjshëm dhe pretendimin nuk e aprovojë".*

42. Gjykata Supreme erdhi në këtë konstatim duke marrë për bazë edhe dëshmitë që ishin marrë për bazë në shpalljen fajtor të parashtruesit, me ç'rast, Gjykata Supreme mes tjerash arsyetoi se *"pretendimi i mbrojtjes se gjykata [Themelore] e ka bazuar aktgjykimin në provë të papranueshme është pretendim i pabazuar, për faktin se gjykata aktgjykimin e ka bazuar edhe në deklaratën e të dënuarit Luan të dhënë në polici (në prezencën e mbrojtësit) i cili ka pohuar se për modifikimin e bunkerit ka qenë në dijeni edhe [F.K.], ai është marr vesh me [personin A.], ky konstatim paraqet një fakt shumë të rëndësishëm për gjykatën, se i dënuari [F.K.] ka qenë në dijeni për bunkerin dhe e ka njohur [personin A.] dhe ka ndenjur me të njëjtin, dhe kjo e bënë të pabazuar këtë pretendim nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë".*

43. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstatoi se edhe pse kishte lëshime procedurale nga ana e Gjykatës Themelore si rezultat i ndërprerjes së

gjykimit për më tepër se tre (3) muaj, megjithatë Gjykata Supreme konstatoi se këto pretendime binin në kategorinë e shkeljeve procedurale relative sipas paragrafit 2 të nenit 384 të KPPK-së. Andaj, në raste të tilla, shkelja procedurale do të ndikonte në ligjshmërinë e një vendimi të tillë, vetëm nëse do të kishte ndikim në vendimin të ligjshëm. Ndërsa sipas Gjykatës Supreme, ky lëshim procedural nuk kishte ndikim në ligjshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Në këtë konstatim, Gjykata Supreme erdhi duke vlerësuar edhe çështjen e keqinterpretimit të deklaratave dhe dëshmive që ishin shqyrtuar nga Gjykata Themelore, duke iu referuar edhe dëshmive që parashtruesi kishte dhënë para policisë në prani të mbrojtësit të tij dhe fakteve tjera. Andaj, Gjykata Supreme duke marrë për bazë faktet e lartcekura kishte trajtuar këto pretendime dhe kishte theksuar se pretendimet e tilla të parashtruesit ishin të pabazuara, pasi lëshimi procedural nuk kishte ndikim në ligjshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

44. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka pasur përfitimet e procedurës kontradiktore; ai ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij, e ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare, gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje. (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues: *Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42; si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).

45. Andaj, Gjykata duke rikujtuar edhe njëherë qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç; nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria), dhe se ajo mund të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të drejtë ose jo arbitrar, vëren se arsyetimi i Gjykatës Supreme, duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të legjislacionit penal, është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta, marrë në tërësinë e tyre, nuk kanë

qenë të padrejta apo arbitrare. (shih: Aktgjykimin e GJEDNJ, *Pekinel kundër Turqisë*, të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 55; shih gjithashtu: në këtë kontekst, ndër të tjera, rastin KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).

46. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta apo përmendja e neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 61; dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 59).

47. Prandaj, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmoj se me vendimin e kontestuar i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

48. Në fund, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit të gabuar dhe zbatimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm janë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të "*shkallës së katërt*"; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], neni 46 [Mbrojta e Pronës], dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës

49. Sa i përket shkeljeve të të drejtave të garantuara me nenet 3, 7, 46 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata rikujton edhe njëherë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (1) (d) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (1) (d) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (1) (d) në veçanti përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë pranueshme nëse: [...]

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese".

50. Gjykata, rikujton se, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, ajo vazhdimisht ka theksuar se: (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

51. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës vetëm pretendon shkelje të neneve 3, 7, 46 dhe 54 të Kushtetutës, por nuk arsyeton ose shpjegon se si ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; dhe KI04/21 cituar më lart, paragrafi 38- 39).

52. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 3, 7, 46 dhe 54 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar siç përcaktohet në paragrafin (1) (d) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

53. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuar me nenet 3, 7, 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës duhet të deklarohen të papranueshme në tërësi si qartazi të pabazuara sepse këto pretendime të parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë e pretendime të "*shkallës së katërt*" ose pretendime të cilat nuk janë qartësuar saktësisht dhe nuk janë paraqitur në mënyrë adekuate faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësi duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është

përcaktuar në paragrafin (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin dhe 39 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin
20.4 të Ligjit;

IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Safet Hoxha	Gresa Caka-Nimani

KI54/21, Parashtrues: Kamber Hoxha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 393/2020, të 1 shkurtit 2021

KI54/21, Aktgjykim i 4 nëntorit 2021, publikuar më 8 dhjetor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për qasje në gjykatë*

Rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me një vendim të vitit 2004 të punëdhënësit, përkatësisht Shërbimit korrektues, Qendra e Paraburgimit në Lipjan, për shkëputjen e marrëdhënies së punës si rezultat i shkeljes disiplinore gjatë orarit të punës. Parashtruesi i kërkesës, fillimisht kishte kontestuar këtë vendim në organin e shkallës së dytë të punëdhënësit, i cili pas 6 (gjashtë) muajsh më vonë, kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Kundër këtij vendimi, parashtruesi i kërkesës kishte filluar procedurat para gjykatave të rregullta. Gjykata Komunale në Lipjan, kishte vendosur në favor të parashtruesit përkatës, duke e detyruar punëdhënësin që të njëjtin ta kthejë në vendin e tij të mëparshëm të punës, duke i njohur atij të gjitha të drejtat që dalin nga kjo marrëdhënie e punës.

Megjithatë, si rezultat i ankesës së punëdhënësit lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës gjatë periudhës të vitit 2006 deri në vitin 2015, procedura ishin zhvilluar në Gjykatën e Qarkut, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, në të cilat kjo kërkesëpadi ishte shqyrtuar si nga aspekti procedural dhe ai i meritave të kërkesëpadisë. Përfundimisht, çështja ishte kthyer në rivendosje në Gjykatën Themelore, dhe e cila sërish kishte aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, dhe duke vendosur sipas ankesës së punëdhënësit, Gjykata e Apelit, kishte prishur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke e refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, kësaj radhe duke konstatuar se padia fillestar ishte paraqitur jashtë afateve ligjore siç është përcaktuar në Ligjit për të Drejtat Themelore të Marrëdhënies së Punës të 28 shtatorit 1989 të RSFJ-së. Duke vepruar sipas kërkesës për revizion, Gjykata e Supreme konfirmoi qëndrimin e Gjykatës së Apelit.

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës i kontestoi konstatimet e lartcekura të Gjykatës Supreme, përfshirë edhe ato të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar se të njëjtat janë nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në të drejtat e tij kushtetuese që ndërlidhen me të drejtën e tij për mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore e të drejtave të përcaktuara përmes neneve 32 [E Drejta për Mjet Juridik] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, respektivisht.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht theksoi se rrethanat faktike dhe juridike të rastit konkret, ngërthejnë elemente të së "*drejtës për qasje në gjykatë*", si pjesë përbërëse e të drejtës në gjykim të drejtë edhe të paanshëm, të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe përcaktuar për pasojë, që pretendimet e parashtruesit të kërkesës do të shqyrtohen nga këndvështrimi i këtyre të drejtave.

Gjykata, në këtë aspekt, duke shtjelluar dhe aplikuar parimet e vendosura përmes praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

(i) interpretimi tejet formalist dhe konstatimi në lidhje me aplikueshmërinë e dispozitave të Ligjit për të Drejtat Themelore të Marrëdhënies së Punës të 28 shtatorit 1989 të RSFJ-së nga ana e Gjykatës Supreme, duke rezultuar në konstatimin se padia fillestare e parashtruesit të kërkesës ishte e jashtëafatshme, sepse i njëjti, në esencë, nuk duhej të priste vendimin e organit të shkallës së dytë, por të vepronte bazuar në heshtjen administrative të të njëjtit, pas një dekade procedurash në të cilat padia e parashtruesit të kërkesës ishte vendosur e rivendosur në merita, nuk është proporcional me qëllimin e ndjekur për garantimin e sigurisë juridike dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, si një ndër parimet bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike; dhe
(ii) si rezultat i këtij interpretimi dhe konstatimi të Gjykatës Supreme, parashtruesit të kërkesës i është mohuar "*e drejta e tij e qasjes në gjykatë*", e drejtë kjo e mishëruar në garancitë procedurale të përcaktuara përmes të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar më Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për pasojë dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se Aktvendimi i kontestuar [Rev. nr. 393/2020] i 1 shkurtit 2021 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe rrjedhimisht, shpalli të njëjtin të pavlefshëm duke e kthyer në rivendosje në pajtueshmëri me konstatimet e Gjykatës Kushtetuese.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI54/21

Parashtrues

Kamber Hoxha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr. 393/2020, të 1 shkurtit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kamber Hoxha, me vendbanim në Podujevë, të cilin e përfaqëson Xhavit Bici, avokat në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev.nr. 393/2020], të 1 shkurtit 2021 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [Ac. nr. 2980/2016] të 19 majit 2020 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit).

3. Parashtruesi i kërkesës Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 2 mars 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 16 mars 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, të cilën e kishte dorëzuar me postë më 16 mars 2021.

7. Më 22 mars 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama - Hajrizi, (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.

8. Më 24 mars 2021, Gjykata njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të dorëzojë: (i) autorizimin për përfaqësim në Gjykatë dhe (ii) kopjet e vendimeve të gjykatave të rregullta.

9. Më 2 prill 2021, përfaqësuesi ligjor dorëzoi autorizimin për përfaqësim dhe dokumentet e kërkuara nga Gjykata.

10. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së

Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

11. Më 20 maj 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

12. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

13. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KK160/21, përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohet kryesuese në Kolegje shqyrtuese në rastet ku është caktuar si anëtare e Kolegjit, duke përfshirë rastin aktual.

14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

15. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, përmes Vendimit KSH.KI54/21 caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi anëtare në Kolegjin Shqyrtues në vend të Arta Rama-Hajrizi, mandati i së cilës si gjyqtare i kishte përfunduar më 26 qershor 2021.

16. Më 4 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi që kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e pranueshme dhe se Aktvendimi [Rev.nr. 393/2020], i 1 shkurtit 2021, i Gjykatës Supreme nuk është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetuese, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Përmbledhja e fakteve

17. Duke filluar nga viti 1999, parashtruesi i kërkesës kishte qenë në marrëdhënie pune si oficer korrektues në Shërbimin korrektues, Qendra e Paraburgimit në Lipjan (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi).

18. Më 17 qershor 2004, punëdhënësi kishte nxjerrë Vendim për shkëputjen e marrëdhënies së punës si rezultat i shkeljes disiplinore gjatë orarit të punës të përcaktuar me Kodin e brendshëm të Disiplinës të Shërbimit Korrektues. Në njoftimin për shkëputje të marrëdhënies së punës nga punëdhënësi ishte specifikuar se si rezultat i fjetjes së parashtruesit të kërkesës gjatë orarit të punës njëri nga të burgosurit kishte kryer vetëvrasje. Vendimi i lartcekur për shkëputjen e marrëdhënies së punës ishte i bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës. Nga shkresat e lëndës po ashtu rezulton që në momentin e shkëputjes së marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës, Qendra e Paraburgimit në Lipjan ishte nën administrimin e Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.

19. Më 13 korrik 2004, parashtruesi i kërkesës, kundër Vendimit të lartcekur të punëdhënësit për shkëputje të marrëdhënies së punës, kishte paraqitur ankesë në organin e shkallës së dytë të punëdhënësit.

20. Më 26 janar 2005, organi i shkallës së dytë i punëdhënësit kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Vendimi i organit të shkallës së dytë të punëdhënësit, i mbështetur në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36, dhe i nënshkruar nga kryesuesi i bordit të ankesave nuk përmbante kështillë ligjore.

21. Më 2 shkurt 2005, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Lipjan (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale) duke kërkuar anulimin e Vendimit, të 17 qershorit 2004, të punëdhënësit për shkëputjen e marrëdhënies së punës dhe Vendimit, të 26 janarit 2005, të organit të shkallës së dytë të punëdhënësit për refuzimin e ankesës së tij.

22. Më 29 mars 2005, Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit [C.nr.27/2005]: (i) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) anuloi vendimet e lartcekura të 17 qershorit 2004 dhe 26 janarit 2005, të punëdhënësit respektivisht; dhe (iii) detyroi punëdhënësin që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e tij të mëparshëm të punës duke i njohur atij të gjitha të drejtat që dalin nga kjo marrëdhënies e punës duke filluar nga data 30 qershor 2004, deri në kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.

23. Në një datë të pasaktësuar, punëdhënësi paraqiti ankesë ndaj Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut).

24. Më 24 nëntor 2006, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit [Ac.nr.990/2005] ankesën e punëdhënësit e aprovoi si të bazuar dhe

prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, C.nr.27/2005, e 29 marsit 2005, duke e kthyer çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata e Qarkut konstatoi se parashtruesi i kërkesës ka statusin e shërbyesit civil, dhe në këtë kontekst Gjykata Komunale në mënyrë të gabuar ka konstatuar dhe vërtetuar gjendjen faktike. Në vijim, Gjykata e Qarkut gjeti se parashtruesi i kërkesës kundër Vendimit, të 17 qershorit 2004, të punëdhënësit për shkëputje të marrëdhënies së punës duhet të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK) si organ i shkallës së dytë.

25. Si rezultat i udhëzimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut, më 14 prill 2007, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [C.nr. 1/2007] vendosi që të ndërpritet procedura e kërkesëpadisë së parashtruesit në këtë gjykatë, deri në nxjerrjen e vendimit nga KPMK.

26. Më 10 dhjetor 2007, KPMK përmes Vendimit [nr. 02/344/2007] hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konstatoi se nuk qëndron udhëzimi i Gjykatës së Qarkut i dhënë përmes Aktvendimit [Ac.nr. 990/2005] të 24 nëntorit 2006 për shkak se në kohën kur parashtruesi i kërkesës kishte kryer shkelje disiplinore, KPMK nuk ka qenë i themeluar.

27. Më 25 shtator 2008, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [C.nr.1/2007] vendosi që të pezullojë procedurën lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës të parashtruar në këtë gjykatë, si rezultat i kërkesës së punëdhënësit për anulim të vendimit në kohëzgjatje për gjashtë (6) muaj.

28. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton që Gjykata Komunale, më 21 janar 2010, përmes Aktgjykimit [C.nr.1/2007] kishte vendosur që: (i) të aprovojë padinë e parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) e detyroi punëdhënësin që parashtruesin e kërkesë ta kthejë në vendin e tij të mëparshëm të punës duke i njohur atij të gjitha të drejtat që dalin nga marrëdhënia e tij e punës.

29. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale, punëdhënësi paraqiti ankesë.

30. Më 7 mars 2014, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.1580/2012] pjesërisht pranoi ankesën e punëdhënësit dhe prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale vetëm sa i përket pikës së dispozitivit përmes së cilës punëdhënësi ishte detyruar që parashtruesit të kërkesës t'i njohë të gjitha të drejtat që dalin nga marrëdhënia e tij e punës.

31. Në një datë të paspecifikuar, punëdhënësi, kundër pikës së dytë të dispozitivit të Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, paraqiti revizion në Gjykatën Supreme.

32. Më 6 janar 2015, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 270/2014] pranoi revizionin e punëdhënësit dhe prishi pikën e dytë të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 1580/2012] të 3 marsit 2014 dhe për këtë pikë lëndën e ktheu në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

33. Më 3 mars 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [C.nr.170/14] e aprovoi në tërësi padinë e parashtruesit të kërkesës duke detyruar punëdhënësin që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e punës si oficer korrektues me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, duke i kompensuar të ardhurat mujore nga 30 qershori 2004 deri në datën e kthimit të tij në vendin e punës.

34. Në një datë të pasaktësuar, punëdhënësi paraqiti ankesë ndaj Aktgjykimit [C.nr.170/14] të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

35. Më 19 maj 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr. 2980/16]: (i) aprovoi ankesën e punëdhënësit; (ii) prishi Aktgjykimin C.nr.170/14, të 3 marsit 2016 të Gjykatës Themelore; dhe (iii) hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës pasi konstatoi se padia e parashtruesit të kërkesës bazuar në nenin 83, paragrafin 1 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, të 28 shtatorit 1989 të RSFJ-së (në tekstin e mëtejmë: LDTHMP) ishte paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar me këtë dispozitë. Paragrafi 1 i nenit 83 të LDTHMP përcaktonte që nëse punëmarrësi nuk është i kënaqur me vendimin definitiv të organit kompetent ose nëse ky organ nuk merr vendim brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, ka të drejtë të kërkojë mbrojte të të drejtave të tij në gjykatën kompetente brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

36. Në këtë rast Gjykata e Apelit konstatoi se *"[...] padia e [parashtruesit të kërkesës] për anulim vendimi dhe kthim në vendin e punës me të drejtat e tjera nga marrëdhënia e punës është e pasaftshme, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi padinë për anulim të vendimit dhe kthim në vendin e punës, në gjykatën e shkallës së parë e ka paraqitur më datë 02.02.2005, ndërsa paditësi ankesën kundër vendimit të dt. 17 .06.2004 e ka paraqitur me dt. 13.07.2004, nga e*

cila rezulton se padia është paraqitë pasi ka kaluar afati ligjor për paraqitjen e padisë, fakti se organi sipas ankesës ka vendosur jashtë afateve të parapara ligjore (dt. 26.01.2005) nuk mundë të rivendos afatet e parapara me ligj për paraqitjen e padisë, nga se paditësi është dashur të presë 30 ditë nga paraqitja e ankesës, nëse brenda këtij afati nuk do të ketë marrë vendimin sipas ankesës organi përkatës, në afatin e ardhshëm prej 15 ditësh, ka qenë i detyruar të paraqesë padinë".

37. Gjykata e Apelit arsyetimin e saj për aplikimin e nenit 83 të LDTHMP-së e arsyetoi duke theksuar se ky ligj ishte në fuqi në kohën kur parashtruesit të kërkesës i është shkëputur marrëdhënia e punës.

38. Në një datë të pasaktësuar, kundër Aktvendimit [Ac.nr.2980/16] të 19 majit 2020, të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Aktvendim i Gjykatës së Apelit të prishet dhe të lihet në fuqi aktgjykimi i shkallës së parë, gjegjësisht Aktgjykimi [C.nr.174/14] i 3 marsit 2016, i Gjykatës Themelore. Në revizionin e tij, parashtruesi i kërkesës përkitazi me konstatimin e Gjykatës së Apelit se kërkesëpadia e tij, e parashtruar në Gjykatën Komunale, ndër tjerash kishte specifikuar se *"çështjen e ushtrimit të padisë e kanë vlerësuar edhe më parë gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.27/2005, datë 29.03.2005, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktvendimin AC. Nr. 990/2005 të datës 24.11.2006, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan me aktgjykimin C.nr. 170/14 datë 03.03.2016, Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin Ac.nr.1580/2012 të datës 07.03.2014, Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin Rev. Nr. 270/2014 të datës 06.01.2015 dhe nga një mori gjyqtarësh të gjitha instancave është shqyrtuar kjo çështje dhe të gjithë kanë vlerësuar se padia është e afatshme, ndërsa kolegji i tanishëm tek pas dekadave ka gjetur se padia është e pasaftshme".*

39. Më 1 shkurt 2021, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.393/2020] refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

40. Gjykata Supreme gjeti se Gjykata e Apelit me *"në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka aprovuar ankesën e [Punëdhënësit] dhe ka vendosur ta hedhë padinë e [parashtruesit të kërkesës] si të pasafatshme, dhe se gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të*

mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë".

41. Gjykata Supreme vërtetoi se parashtruesi i kërkesës padinë e tij, të 2 shkurtit 2005 në Gjykatën Komunale, kundër Vendimit të shkallës së dytë të punëdhënësit të 26 janarit 2005, e ka parashtruar jashtë afatit, për arsye se organi i shkallës së dytë ka vendosur jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh. Sipas Gjykatës Supreme afati i përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 83 të LDTHMP-së *"është afat prekluziv, me kalimin e afatit humbet e drejta gjyqësore*" dhe se për pasojë ky afat nuk mund të rivendoset.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

43. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij thekson se *"Gjykata Supreme ka shkelur dispozitat e nenit 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës, duke i mohuar të drejtën e ushtrimit të padisë sipas afatit që iu është dhënë paditësit me rastin e vendosjes nga organi i shkallës së dytë pra në afat është ushtruar padia sepse organi i shkallës së dytë ka vendosur më 26 .01.2005 ndërsa padia më 02.02.2005, dmth pas gjashtë ditësh që është vendosë sipas ankesës".*

44. Rrjedhimisht, parashtruesi specifikon se mospranimi i afatit të padisë nga Gjykata Supreme përbën *"shkelje të drejtave për ankesë ushtrim-padi dhe mbrojtje pra është shkel ligji në dëm të kërkuesit".*

45. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) të shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të anulojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr.393/2020] të 1 shkurtit 2021 dhe Aktvendimin [Ac.nr.2980/2016] të 19 majit 2020 të Gjykatës së Apelit.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

Neni 32
[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 54
[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë".

Rregullorja e UNMIK-ut nr 1999/24 për Ligjet në Fuqi në Kosovë, e ndryshuar përmes Rregullores 2000/59

"Neni 1
Ligji në Fuqi

1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin:
(a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe

(b) Ligjin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.

1.2. Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj.

1.3. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet t'i respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut [...]."

Ligji për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, i 28 shtatorit 1989 i RSFJ-së

"Punëtori i cili nuk është i kënaqur me vendimin definitiv të organit kompetent në organizatë ose në qoftë se ky organ nuk merr vendim brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës përkatësisht kundërshtimit ka të drejtë që në afatin e ardhshëm prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të veta para gjykatës kompetente.."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

46. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

48. Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
> *2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

Neni 49
(Afatet)

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]."*

49. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin

[Rev.nr.393/2020] të 1 shkurtit 2021 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

50. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

51. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

52. Gjykata rikujton se më 17 qershor 2004, punëdhënësi i parashtruesit të kërkesës kishte nxjerrë Vendim për shkëputjen e marrëdhënies së punës si rezultat i shkeljes disiplinore gjatë orarit të punës. Si rezultat i kësaj, parashtruesi kërkesës më 13 korrik 2004, kundër Vendimit të punëdhënësit për shkëputjen e marrëdhënies së punës kishte paraqitur ankesë në organin e shkallës së dytë të punëdhënësit. Më 26 janar 2005, gjegjësisht më shumë se gjashtë (6) muaj më vonë, organi i shkallës së dytë kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Si rezultat i vendimit të organit të shkallës së dytë të punëdhënësit, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale, me kërkesë të anulimit të Vendimit të 17 qershorit 2004 të punëdhënësit për shkëputje të marrëdhënies së punës. Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit [C.nr.27/2005] të 29 marsit 2005 kishte: (i) aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) anuluar vendimet e lartcekura të 17 qershorit 2004 dhe 26 janarit 2005, respektivisht të punëdhënësit; dhe (iii) detyruar punëdhënësin që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e tij të mëparshëm të punës duke i njohur atij të gjitha të drejtat që dalin nga kjo marrëdhënies e punës duke filluar nga 30 qershori 2004, deri në kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës. Si rezultat i ankesës së punëdhënësit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, Gjykata e Qarkut përmes Aktvendimit [Ac. Nr. 990/2005] të 24 nëntorit 2006, kishte aprovuar ankesën e punëdhënësit si të bazuar dhe e kishte kthyer çështjen në rigjykim në Gjykatën Komunale, duke konstatuar

se parashtruesi i kërkesës kishte statusin e shërbyesit civil dhe për pasojë ai ishte i obliguar që të parashtrojë ankesë në KPMK si organ i shkallës së dytë. Si rezultat i udhëzimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut, Gjykata Komunale, më 14 prill 2007 kishte ndërprerë procedurën e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës deri në nxjerrjen e vendimit nga ana e KPMK-së. Megjithatë, më 10 dhjetor 2007, KPMK, kishte hedhur poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës duke arsyetuar se udhëzimi i Gjykatës së Qarkut është i gabuar dhe parashtruesi i kërkesës nuk ka të drejtë të parashtrojë ankesë në KPMK, pasi që kjo e fundit nuk kishte qenë e themeluar në kohën kur parashtruesi i kërkesës kishte kryer shkeljen disiplinore. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton që çështja e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës ishte rikthyer për gjykim në Gjykatën Komunale, dhe kjo e fundit përmes Aktgjykimit [C.nr.1/2007] të 21 janarit 2010 kishte aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe kishte vendosur që këtë të fundit ta kthejë në vendin e tij të mëparshëm të punës. Si rezultat i ankesës së parashtruar nga punëdhënësi, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.1580/2012] të 7 marsit 2014 pjesërisht kishte aprovuar ankesën e këtij të fundit, dhe kishte prishur Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, të 21 janarit 2010, vetëm sa i përket pikës së dytë të dispozitivit që ndërlidhej me obligimin e punëdhënësit që t'i njohë të gjitha të drejtat e tij që dalin nga marrëdhënia e tij e punës. Kundër këtij Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, punëdhënësi kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme, dhe kjo e fundit përmes Aktvendimit [Rev.nr.270/2014] të 6 janarit 2015, kishte pranuar revizionin e tij si të bazuar dhe kishte prishur pikën e dytë të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.1580/2012] të 7 marsit 2014 duke e kthyer për këtë pikë lëndën në rigjykim në shkallën e parë. Gjykata Themelore sërish, përmes Aktgjykimit [C.nr.174/14] të 3 marsit 2016 kishte aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe punëdhënësin e kishte detyruar që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e tij të mëparshëm të punës me të gjitha të drejta nga marrëdhënia e tij e punës. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.2980/16] të 19 majit 2020: (i) kishte aprovuar ankesën e punëdhënësit; (ii) kishte prishur Aktgjykimin [C.nr.170/14] të 3 marsit 2016 të Gjykatës Themelore; (iii) kishte hedhur poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës pasi kishte konstatuar se padia e parashtruesit të kërkesës, bazuar në nenin 83, paragrafin 1 të LDTHMP të 28 shtatorit 1989 të RSFJ-së, ishte paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar me këtë dispozitë. Gjegjësisht, duke u bazuar në këtë dispozitë, Gjykata e Apelit kishte interpretuar dhe më pas kishte konstatuar që nëse punëmarrësi, respektivisht parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me vendimin definitiv të organit kompetent, përkatësisht Vendimin e 17 qershorit 2004, ose nëse ky organ nuk merr vendim,

përkatësisht organi i shkallës së dytë brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, ka të drejtë të kërkojë mbrojte të të drejtave të tij në gjykatën kompetente brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit konstatoi se parashtruesi i kërkesës në bazë të kësaj dispozitë është dashur që të parashtrojë kërkesës në Gjykatën Komunale brenda pesëmbëdhjete ditëve nga kalimi i afatit tridhjetë ditor nga dita e parashtrimit të ankesës së tij në organin e shkallës së dytë të punëdhënësit. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur revizion kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme, dhe kjo e fundit përmes Aktvendimit [Rev.nr. 393/2020] të 1 shkurtit 2021 revizionin e tij e kishte refuzuar si të pabazuar. Ngjashëm si Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës kërkesëpadinë e tij të 2 shkurtit 2005 në Gjykatën Komunale, kundër Vendimit të shkallës së dytë të punëdhënësit të 26 janarit 2005, e ka parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 83 të LDTHMP. Gjykata Supreme po ashtu kishte vërtetuar se LDTHMP ishte ligji në fuqi në kohën kur parashtruesi i kërkesës kishte themeluar marrëdhënien e tij të punës me punëdhënësin, dhe sipas dispozitës së lartcituar të këtij ligji, afati i përcaktuar në këtë dispozitë, përkatësisht paragrafi 1 i nenit 83 të LDTHMP-së *"është afat prekluziv, me kalimin e afatit humbet e drejta gjyqësore*" dhe se për pasojë ky afat nuk mund të rivendoset.

53. Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e lartcekura përmes Aktvendimeve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme duke pretenduar shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij specifikon se atij i është *"[...] mohuar [e drejta] e ushtrimit të padisë sipas afatit që iu është dhënë paditësit me rastin e vendosjes nga organi i shkallës së dytë pra në afat është ushtruar padia sepse organi i shkallës së dytë ka vendosur më 26 .01.2005 ndërsa padia më 02.02.2005, dmth pas gjashtë ditësh që është vendosë sipas ankesës"*. Rrjedhimisht, parashtruesi specifikon se mospranimi i afatit të padisë nga Gjykata Supreme përbën shkelje të së drejtës së tij *"për ankesë ushtrim-padi dhe mbrojtje pra është shkel ligji në dëm të kërkuesit"*.

54. Në vijim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka pretenduar shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Megjithatë, Gjykata duke u bazuar në rrethanat faktike dhe juridike të rastit vëren se përveç pretendimit të tij për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në

kërkesën e tij ngërthejnë elemente të së drejtës për "qasjes në gjykatë" si pjesë përbërëse e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

55. Në aspekt të trajtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në kuadër të fushëveprimit të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të vetë Gjykatës dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) thekson se ajo nuk është kushtëzuar nga karakterizimi i shkeljeve të pretenduara nga parashtruesi i kërkesës. Në frymën e parimit *juria novit curia*, Gjykata është vet zotëruese e karakterizimit të çështjeve kushtetuese që mund të ngërthej një rast, dhe me vullnetin e vet mund të shqyrtojë ankesat përkatëse, duke u mbështetur në dispozita ose paragrafë në të cilat nuk janë thirrur, shprehimisht, palët (shih në këtë kontekst rastin e Gjykatës, KI48/18, me parashtrues *Ahmet Frangu*, Aktgjykim, i 22 korrikut 2020, paragrafi 81).

56. Në vijim, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, një ankesë karakterizohet nga faktet që përmban ajo dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet e referuara shprehimisht në të nga palët (shih rastin e GJEDNJ-së *Talpis kundër Italisë*, Aktgjykim i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e përmendura aty).

57. Prandaj, dhe në vijim, Gjykata do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës nga këndvështrimi i të drejtave të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke aplikuar edhe parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në të cilin rast Gjykata në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e obliguar që *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

58. Në këtë drejtim, Gjykata së pari vëren se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës vazhdimisht konsideron se drejtësia e procedurës vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih rastet e Gjykatës KI62/17, parashtruese: *Emine Simnica*, Aktgjykim i 29 majit 2018, paragrafi 41; dhe KI20/21, parashtruese *Violeta Todorović*, Aktgjykim, i 13 prillit 2021, paragrafi 38; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 tetorit 1988, paragrafi 68). Prandaj, në procedurën e vlerësimit të bazës së pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'u përmbahet këtyre parimeve.

59. Në këtë aspekt dhe me qëllim të trajtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të shtjellojë parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për "qasje në gjykatë", të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për aq sa janë relevante në rrethanat e rastit konkret, në mënyrë që të vlerësohet aplikueshmëria e këtyre neneve, për të vazhduar me aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret.

I. Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për "qasje në gjykatë" të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si dhe praktika relevante gjyqësore

(i) Parimet e përgjithshme

60. Përkitazi me të drejtën për "qasje në gjykatë", e drejtë kjo e garantuar me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë gjyqësore, e cila është ndërtuar duke u bazuar në parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Aktgjykim, i 21 shkurtit 1975; *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke,* Aktgjykim i 12 nëntorit 2002; *Miragall Escolano dhe të Tjerët kundër Spanjës,* Aktgjykim, i 25 janarit 2000; dhe *Naït-Liman kundër Zvicrës,* Aktgjykim i 15 marsit 2018.) Thënë këtë, rastet e Gjykatës përmes të cilave Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ dhe të njëjtat i ka aplikuar edhe në rastet për shqyrtim para saj, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI62/17, me parashtruese të kërkesës *Emine Simnica* [Aktgjykim, i 29 majit 2018]; KI224/19 me parashtrues *Islam Krasniqi* [Aktgjykim, i 10 dhjetorit 2020] dhe KI20/21 me parashtruese *Violeta Todorović* [Aktgjykim, i 13 prillit 2021].

61. Në kuptim të kësaj, Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht rastit *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ku ishte theksuar se "*e drejta e qasjes në gjykatë përbën një element që është i pandarë në të drejtën e përcaktuar në nenin 6, paragrafin 1 [të KEDNJ-së]. Neni 6, paragrafi 1 u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedurë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre civile pranë një gjykate ose tribunali. Në këtë mënyrë, ky nen përfshin "të drejtën për një gjykatë", nga e cila e drejta e qasjes, përkatësisht e drejta për të filluar procedura pranë gjykatave në çështjet civile, përbën vetëm një aspekt të kësaj të drejte"*

(shih rastin e GJEDNJ-së Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, i cituar më lart, paragrafët 28-36).

62. Gjykata në këtë kontekst thekson se e "drejta e qasjes në gjykatë", si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, përcakton që palët në procedurë duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih rastet e Gjykatës K224/19, me parashtrues *Islam Krasniqi*, të cituar më lart, paragrafi 35; dhe KI20/21, me parashtrues *Violeta Todorović*, të cituar më lart, paragrafi 41; shih në këtë kontekst edhe rastet e GJEDNJ-së, *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke,* të cituar më lart, paragrafi 49; dhe *Naït-Liman kundër Zvicrës*, të cituar më lart, paragrafi 112).

63. Gjykata më tej thekson se e drejta për qasje në gjykatë nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve, pasi që nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një liri të caktuar vlerësimi në këtë drejtim (shih në lidhje me këtë rastin e Gjykatës KI20/21, me parashtruese *Violeta Todorović*, të cituar më lart, paragrafi 44).

64. Megjithatë, çdo kufizim i të drejtës së qasjes në gjykatë nuk duhet të kufizojë ose zvogëlojë qasjen e një personi në atë mënyrë apo në një masë të tillë që të dëmtohet vetë esenca e "së drejtës në gjykatë". Kufizimet e tilla nuk do të jenë të arsyetuara nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet (shih rastin e Gjykatës KI20/21, parashtruese *Violeta Todorović*, të cituar më lart, paragrafi 45, dhe rastet e GJEDNJ-së: *Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 nëntorit 2000, paragrafi 15, dhe *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke,* Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi, 61).

(ii) praktika gjyqësore e GJEDNJ-së

65. Gjykata bazuar edhe në rrethanat e rastit konkret i referohet edhe praktikës përkatëse të GJEDNJ-së që i referohet të drejtës për qasje në gjykatë, nga këndvështrimi i garantimit të parimit të sigurisë juridike dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, si parime bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike.

66. Në praktikën e saj gjyqësore GJEDNJ kishte specifikuar se rregullat të cilat përcaktojnë hapat formal që duhet të ndërmerren dhe afatin kohor që duhet të respektohet në parashtrimin e një ankese kanë për

qëllim administrimin e mirëfilltë të drejtësisë dhe të njëjtat duhet të shqyrtohen në pajtueshmëri, e në veçanti me parimet e sigurisë juridike (shih rastin e GJENDJ-së *Cañete de Goñi kundër Spanjës*, Aktgjykim, i 15 tetorit 2002, paragrafi 36). Thënë këtë, GJEDNJ kishte specifikuar që rregullat përkatëse ose aplikimi i tyre nuk duhet që t'i pengojnë palët ndërgjygjëse nga përdorimi i një mjeti juridik në dispozicion (shih në këtë kontekst rastin e GJEDNJ-së *Miragall Escolano dhe të Tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim, i 25 janarit 2000, paragrafi 36). GJEDNJ, po ashtu kishte nënvizuar se çdo rast duhet të shqyrtohet në dritën e rrethanave dhe elementeve specifike të procedurës në atë rast (shih rastin *Kurşun kundër Turqisë*, Aktgjykim, i 30 tetorit 2018, paragrafët 103-104). Në kuptim të kësaj, GJEDNJ, më tej kishte nënvizuar se në aplikimin e rregullave procedurale, gjykatat duhet të mënjanojnë sikurse formalizmin e tepruar që do ta pamundësonte procedurën e drejtë ashtu edhe fleksibilitetin e tepruar që do t'i bënte kriteret procedurale të përcaktuara me ligj të pavlera (shih rastin *Hasan Tunç dhe të Tjerët kundër Turqisë*, Aktgjykim, i 31 janarit 2017, paragrafët 32-33).

67. Në mënyrë të përmbledhur, GJEDNJ në rastin *Zubac kundër Kroacisë* kishte theksuar se "*respektimi i rregullave formale në procedurë civile [...] është më vlerë dhe një rëndësie të tillë që ndalon arbitraritetin, dhe siguron vendimmarrjen efektive përkitazi me një kontest dhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm kohor, si dhe siguron siguri juridike dhe respekt për gjykatën* (shih rastin *Zubac kundër Kroacisë* [DHM], Aktgjykim, i 5 prillit 2018, paragrafi 96). GJEDNJ po në këtë rast po ashtu kishte nënvizuar se *"megjithatë, e drejta për qasje në gjykatë konsiderohet se është dëmtuar në atë moment kur rregullat pushojnë të jenë në shërbim të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe për pasojë krijojnë një barrierë e cila i pamundëson palëve ndërgjygjëse që rasti i tyre të gjykohet në merita nga gjykata kompetente* (paragrafi 98 i Aktgjykimit në rastin *Zubac kundër Kroacisë)*. Në kontekst të kësaj të fundit, GJEDNJ kishte theksuar se në rastet kur autoritetet publike kanë dhënë një informatë të pasaktë apo të pakompletuar, gjykatat vendore duhet që në mënyrë të mjaftueshme të kenë parasysh rrethanat specifike të rastit në mënyrë që të mos aplikojnë rregullat dhe praktikën e tyre në mënyrë shumë të ngurtë (shih në këtë kuptim edhe rastin e GJEDNJ-së *Clavien kundër Zvicrës,* Vendim, i 12 shtatorit 2017, paragrafi 27 *dhe Gajtani kundër Zvicrës,* Aktgjykim, i 9 shtatorit 2014, paragrafi 75).

68. Në anën tjetër, GJEDNJ në rastin *Ivanova and Ivashova* kundër Rusisë [Aktgjykim, i 26 janarit 2017] konstatoi se gjykatat vendore nuk duhet që të interpretojnë ligjin në mënyrë jo fleksibile, i cili rezulton

në imponimin e një detyrimi të cilin palët ndërgjygjëse e kanë të pamundur që ta respektojnë. Sipas GJEDNJ-së duke kërkuar që një ankesë të parashtrohet brenda një muaji nga data në të cilën zyra e regjistrimit hartoi një kopje të plotë të vendimit të gjykatës - në vend të ditës nga e cila paditësja ishte njoftuar në lidhje me vendimin - rezultoi në atë që kalimi i afatit të ankesës të ishte në varësi të një faktori tërësisht jashtë kontrollit të paditëses. Rrjedhimisht GJEDNJ kishe konstatuar se e drejta e ankesës duhej të ishte efektive që nga dita kur paditësja ishte vënë në dijeni përkitazi me tekstin e plotë të vendimit. Në këtë rast, GJEDNJ kishte konkluduar se veprimi i kontestuar nuk ishte proporcional me qëllimin e garantimit të sigurisë juridike dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, dhe rrjedhimisht konstatoi se ishte e drejta e saj për qasje në gjykatë e garantuar me nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së (shih paragrafët 52-58 të Aktgjykimit në rastin *Ivanova and Ivashova kundër Rusisë*).

(iii) Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese përkitazi me të drejtën për qasje në gjykatë

69. Gjykata, ashtu siç ka specifikuar edhe më lart, parimet e lartcekura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së i ka aplikuar edhe në praktikën e saj gjyqësore. Në mënyrë specifike Gjykata, ashtu edhe si më lart, iu është referuar tri rasteve të Gjykatës, përkatësisht rasteve KI62/17, me parashtruese *Emine Simnica*, KI224/19 me parashtrues *Islam Krasniqi,* dhe KI20/21 me parashtruese *Violeta Todorović*, në të cilat raste Gjykata kishte konstatuar shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë, të garantuar e nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

70. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet rastit të saj të fundit, në të cilin rast kjo e fundit duke iu referuar dhe aplikuar parimet e lartcekura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së kishte konstatuar shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë, si një nga parimet e një gjykimi të drejtë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Rrethanat e rastit të parashtrueses së kërkesës në rastin KI20/21 ndërlidhen me atë se më 21 tetor 2019, parashtruesja e kërkesës, në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Suprem për çështje që lidhen me Agjencinë e Privatizimit të Kosovës kishte paraqitur një kërkesë për përmirësimin e gabimit të qartë teknik, të Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, të 4 tetorit 2019, duke pretenduar se Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, të 24 majit 2016 e kishte pranuar më 3 qershor 2016, derisa ankesën kundër këtij Aktgjykimi në Kolegjin e Apelit e kishte parashtruar më 15 qershor 2016, brenda afatit prej 21 ditëve. Më 1 tetor 2020, Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit e kishte hedhur poshtë kërkesën e parashtrueses

së kërkesës si të papranueshme duke shtuar se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit i 4 tetorit 2019, është përfundimtar, edhe pse erdhi në përfundim që deklaratat e parashtrueses së kërkesës që Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar është pranuar nga parashtruesja, më 3 qershor 2016, ishin të sakta. Gjykata në shqyrtimin e pretendimit të parashtrueses së kërkesës në lidhje me të drejtën e "qasjes në gjykatë" gjeti se Kolegji i Apelit përkundër faktit që gjeti se pretendimet e parashtrueses së kërkesës ishin të sakta, dhe rrjedhimisht se ankesa e saj ishte parashtruar sipas afateve të përcaktuara me ligjin në fuqi, kjo e fundit refuzoi kërkesën e parashtrueses për përmirësim të gabimit të Kolegjit të Apelit përmes Aktgjykimit të 4 tetorit 2019, duke e konsideruar kërkesën e saj si kërkesë për rishqyrtim të vendimit gjyqësor. Si rezultat i kësaj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit i pamundësoi parashtrueses së kërkesës që ankesa e saj ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të trajtohej në merita përkundër faktit që ankesa e saj ishte paraqitur brenda afatit ligjor. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se Kolegji i Apelit i kishte kufizuar parashtrueses së kërkesës qasjen në gjykatë, i cili kufizim kishte rezultuar në shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

II. Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

71. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës më 13 korrik 2004, kundër Vendimit të punëdhënësit për shkëputjen e marrëdhënies së punës, të 17 qershorit 2004 kishte paraqitur ankesë në organin e shkallës së dytë të punëdhënësit. Më 26 janar 2005, gjegjësisht më shumë se gjashtë (6) muaj më vonë, organi i shkallës së dytë kishte nxjerrë vendim, përmes së cilit kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe si rezultat i vendimit të organit të shkallës së dytë të punëdhënësit, parashtruesi i kërkesës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale, me kërkesë të anulimit të Vendimit të 17 qershorit 2004, të Punëdhënësit për shkëputje të marrëdhënies së punës. Gjykata në këtë rast vë në pah, se vendimi i organit të shkallës së dytë të Punëdhënësit nuk përmbante kështillë juridike në lidhje me mjetet juridike. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu vë në pah se baza ligjore e nxjerrjes së këtij vendimi, e cila ishte përmendur në preambulë të këtij Vendimi ishte Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil. Si pasojë e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, Gjykata Komunale duke shqyrtuar kërkesëpadinë e tij në merita përmes Aktgjykimit C.nr.27/2005, të 29 marsit 2005 kishte aprovuar kërkesëpadinë e tij duke detyruar punëdhënësin që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e tij të mëparshëm të punës. Nga momenti i parashtrimit të ankesës kundër

këtij Aktgjykimit të Gjykatës Komunale nga ana e punëdhënësit në Gjykatën e Qarkut gjegjësisht në vitin 2005 deri në nxjerrjen e Aktvendimeve të kontestuara [Ac.nr. 2980/16] të 19 majit 2020 të Gjykatës së Apelit dhe [Rev.nr.393/2020] të 1 shkurtit 2021 të Gjykatës Supreme, çështja e kërkesëpadisë së parashtruesit ashtu siç është elaboruar detajisht si më lart për pesëmbëdhjetë (15) vite ishte trajtuar para gjykatave të rregullta si nga aspekti i lejueshmërisë ashtu edhe nga aspekti i meritave të kërkesëpadisë.

72. Në këtë kontekst, Gjykata duke u bazuar në kronologjinë procedurale të këtij rasti para gjykatave të rregullta, dhe në kuptim të së "drejtës për qasje" në gjykatë, vëren se parashtruesi i kërkesës ka pasur qasje në gjykatë gjatë gjithë kësaj periudhe, deri në momentin e nxjerrjes së Aktvendimit [Ac.nr.2980/16] të 19 majit 2020, të Gjykatës së Apelit përmes së cilit ishte vendosur që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës të hudhet poshtë si e pasafatshme pasi kjo gjykatë duke u bazuar në nenin 83, paragrafin 1 të LDTHMP, të 28 shtatorit 1989 të RSFJ-së kishte konstatuar se kërkesëpadia e tij ishte paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar me këtë dispozitë. Gjegjësisht, Gjykata e Apelit duke u bazuar në këtë dispozitë, konstatoi se parashtruesi i kërkesës kërkesëpadinë e tij në Gjykatën Komunale është dashur ta parashtrojë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga kalimi i afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti i parashtrimit të ankesës së tij në organin e shkallës së dytë të Punëdhënësit. Po ashtu edhe Gjykata Supreme në refuzimin e revizionit të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kishte vërtetuar konstatimin e Gjykatës së Apelit përmes Aktvendimit të lartcekur, të 19 majit 2020.

73. Gjykata përsërit se arsyeja kryesore për refuzimin e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Supreme, respektivisht ishte sepse këto të fundit duke interpretuar dhe aplikuar nenin 83, paragrafin 1 të LDTHMP, të 28 shtatorit 1989 të RSFJ-së kishin ardhur në përfundim se kërkesëpadia e tij ishte parashtruar jashtë afatit kohor të përcaktuar me këtë dispozitë. Sipas interpretimit të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, parashtruesi i kërkesës është dashur që kërkesëpadinë e tij në Gjykatën Komunale ta parashtrojë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga kalimi i afatit tridhjetë (30) ditor të parashtrimit të ankesës së tij në organin e shkallës së dytë.

74. Thënë këtë, Gjykata rikujton se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës: (i) organi i shkallës së dytë i punëdhënësit nuk kishte nxjerrë vendim brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e parashtrimit të ankesës së parashtruesit të kërkesës kundër Vendimit për shkëputje të marrëdhënies së punës, të 17 qershorit 2004 të Punëdhënësit; (ii) por

kishte nxjerrë vendim më 26 janar 2005, respektivisht gjashtë (6) muaj pas parashtrimit të ankesës së parashtruesit të kërkesës në këtë organ; dhe (iii) parashtruesi i kërkesës kundër këtij Vendimi të shkallës së dytë, të nxjerrë me 26 janar 2005 brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, respektivisht më 2 shkurt 2005 kishte parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Komunale.

75. Thënë këtë, mbetet të përcaktohet nëse Aktvendimi [Ac.nr.2980/16] i 19 majit 2020, i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi [Rev.nr.393/2020] i 1 shkurtit 2021 i Gjykatës Supreme, përmes së cilëve kërkesëpadia e tij u konstatua si e pasafatshme në mënyrë efektive ia mohuan parashtruesit të kërkesës "të drejtën e qasjes në gjykatë" nga këndvështrimi i parimit të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike, si dhe garancitë e përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Në kuptim të kësaj dhe bazuar në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse interpretimi dhe aplikimi i paragrafit 1 të nenit 83 të LDTHMP-së nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme për hudhjen poshtë të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës pas pesëmbëdhjetë (15) viteve të zhvillimit të procedurës kontestimore përkitazi me kërkesëpadinë e tij në këtë rast i (i) kanë mohuar atij të drejtën për qasje në gjykatë dhe për pasojë (ii) i kanë pamundësuar parashtruesit të kërkesës që rasti i tij të vazhdojë të shqyrtohet në meritat e kërkesës.

76. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet konstatimeve të dhëna nga GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, ku, ndër tjerash kishte theksuar se: (i) rregullat të cilat përcaktojnë kriteret formale që duhet të respektohen në lidhje me afatin kohor në parashtrimin e një ankese kanë për qëllim administrimin e mirëfilltë të drejtësisë dhe të njëjtat duhet të shqyrtohen në pajtueshmëri, e në veçanti në pajtim me parimet e sigurisë juridike (shih rastin e GJENDJ-së *Cañete de Goñi kundër Spanjës*, të cituar më lart, paragrafi 36); (ii) çdo rast duhet të shqyrtohet në dritën e rrethanave dhe elementeve specifike të procedurës në atë rast (shih rastin *Kurşun kundër Turqisë*, të cituar më lart, paragrafët 103-104); dhe (iii) gjykatat duhet të mënjanojnë sikurse formalizmin e tepruar që do ta pamundësonte procedurën e drejtë ashtu edhe fleksibilitetin e tepruar që do t'i bënte kriteret procedurale të përcaktuara me ligj të pavlera (shih rastin *Hasan Tunç dhe të Tjerët kundër Turqisë*, Aktgjykim, të cituar më lart, paragrafët 32-33).

77. Në vijim të kësaj, Gjykata duke u bazuar në qëndrimet e dhëna përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së do të vlerësojë nëse Gjykata Supreme nga këndvështrimi i administrimit të mirëfilltë të drejtësisë dhe respektimi i parimit të sigurisë juridike gjatë interpretimit dhe

aplikimit të dispozitave përkatëse ligjore, përkatësisht paragrafit 1 të nenit 83 të LDTHMP-së përkitazi me afatshmërinë e kërkesëpadisë: (i) ka marrë për bazë rrethanat specifike të rastit, përkatësisht rrethanat e procedurës së zhvilluar para gjykatave të rregullta, dhe në këtë kuptim të kësaj të fundit (ii) ka mënjanuar formalizmin e tepruar.

78. Gjykata, fillimisht duke iu referuar shkresave të lëndës, vëren se Vendimi për shkëputjen e marrëdhënies së punës i punëdhënësit i 17 qershorit 2004 ishte i bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil [Rregullore e UNMIK-ut 2001/36], dhe po ashtu vëren se Vendimi i organit të shkallës së dytë i cili po ashtu bazohej në këtë ligj nuk përmbante kështillë ligjore. Për më tepër, përgjatë procedurave të zhvilluara para gjykatave të rregullta, për aq sa mund të konstatohet nga shkresat e lëndës, gjykatat e rregullta nuk kishin konstatuar më parë se në rastin e parashtruesit të kërkesës si ligj në fuqi ishte LDTHMP. Konstatimi i gjykatave të rregullta se ligj i aplikueshëm në rastin e parashtruesit të kërkesës është LDTHMP, për herë të parë ishte dhënë përmes Aktvendimit [Ac.nr. 2980/16] të 19 majit 2020, të Gjykatës së e Apelit, të cilin konstatim e kishte vërtetuar edhe Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.393/2020] të 1 shkurtit 2021.

79. Në kontekst të kësaj, Gjykata i referohet Aktvendimit [Ac.nr. 2980/16] të 19 majit 2020, të Gjykatës së e Apelit, përmes së cilit fillimisht ishte (i) konstatuar se paragrafi 1 i nenit 83 i LDTHMP ishte i aplikueshëm në rastin e parashtruesit të kërkesës, pasi ky ligj ishte në fuqi në momentin e shkëputjes së marrëdhënies së tij të punës dhe si rezultat i kësaj (ii) kishte konkluduar se *"[...] padia e [parashtruesit të kërkesës] për anulim vendimi dhe kthim në vendin e punës me të drejtat e tjera nga marrëdhënia e punës është e pasaftshme, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi padinë për anulim të vendimit dhe kthim në vendin e punës, në gjykatën e shkallës së parë e ka paraqitur më datë 02.02.2005, ndërsa paditësi ankesën kundër vendimit të dt. 17 .06.2004 e ka paraqitur me dt. 13.07.2004, nga e cila rezulton se padia është paraqitë pasi ka kaluar afati ligjor për paraqitjen e padisë, fakti se organi sipas ankesës ka vendosur jashtë afateve të parapara ligjore (dt. 26.01.2005) nuk mundë të rivendos afatet e parapara me ligj për paraqitjen e padisë, nga se paditësi është dashur të presë 30 ditë nga paraqitja e ankesës, nëse brenda këtij afati nuk do të ketë marrë vendimin sipas ankesës organi përkatës, në afatin e ardhshëm prej 15 ditësh, ka qenë i detyruar të paraqesë padinë".*

80. Në vijim, Gjykata po ashtu rikujton konstatimin e dhënë në Aktvendimin [Rev.nr. 393/2020] e 1 shkurtit 2021, të Gjykatës Supreme, përmes së cilit ishte vërtetuar se Gjykata e Apelit me *"në*

mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka aprovuar ankesën e [Punëdhënësit] dhe ka vendosur ta hedhë padinë e [parashtruesit të kërkesës] si të pasafatshme, dhe se gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cita i pranon edhe kjo Gjykatë". Gjykata Supreme vërtetoi se parashtruesi i kërkesës padinë e tij, të 2 shkurtit 2005, në Gjykatën Komunale kundër Vendimit të shkallës së dytë të punëdhënësit, të 26 janarit 2005 e ka parashtruar jashtë afatit, për arsye se organi i shkallës së dytë ka vendosur jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh. Sipas Gjykatës Supreme afati i përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 83 të LDTHMP-së *"është afat prekluziv, me kalimin e afatit humbet e drejta gjyqësore*" dhe se për pasojë ky afat nuk mund të rivendoset.

81. Në lidhje me konstatimet e Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, Gjykata thekson se nuk konteston apo vë në pikëpyetje përmbajtjen e dispozitës përkatëse ligjore, si dhe konstatimin e këtyre gjykatave në lidhje me aplikimin e këtij ligji, i cili konstatim bie në sferën e ligjshmërisë.

82. Për më tepër, Gjykata në kuptim të administrimit të mirëfilltë të drejtësisë vë në pah se aplikimi i rregullave formale dhe procedurale që ndërlidhen me lejueshmërinë e rastit është i një rëndësie të tillë që i shërben sigurisë juridike gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore para gjykatave të rregullta.

83. Megjithatë, ashtu siç është interpretuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata vlerëson se kur interpretimi i rregullave procedurale rezulton në një formalizëm të tepruar atëherë ky interpretim pushon të jetë në shërbim të sigurisë juridike dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë dhe për pasojë mund të rrezikojë qasjen e parashtruesve në gjykatë.

84. Në vijim, Gjykata po ashtu vë në pah se në rastet kur autoritetet publike kanë dhënë një informatë të pasaktë apo të pakompletuar, gjykatat e rregullta gjatë interpretimit dhe aplikimit të rregullave formale dhe procedurale në mënyrë të mjaftueshme duhet që të marrin për bazë këtë fakt apo rrethanat specifike që ndërlidhen me zhvillimin e procedurës. Në kontekst të rastit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet të vlerësojë nëse gjykata e rregullta, përkatësisht Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme kanë marrë për bazë (i) rrethanat specifike të rastit të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht kanë marrë për bazë faktin që Vendimi për shkëputjen e marrëdhënies së punës, i 17 qershori 2004 dhe Vendim i organit të shkallës së dytë,

i 26 janarit 2005 i punëdhënësit, respektivisht ishin të bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil dhe ky i fundit nuk përmbante as këshillë juridike; dhe (ii) procedurën e zhvilluar përgjatë pesëmbëdhjetë (15) viteve, në të cilën procedurë rasti i parashtruesit të kërkesës ishte shqyrtuar si në aspektin procedural dhe atë të meritave të rastit, por në të cilën procedurë deri në nxjerrjen e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, të 19 majit 2020 nuk ishte shqyrtuar çështja e afatshmërisë së kërkesëpadisë së tij.

85. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata, duke aplikuar qëndrimet dhe konstatimet e GJEDNJ-së, vëren se gjykatat e rregullta, përkatësisht Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme gjatë interpretimit dhe zbatimit të nenit 83, paragrafit 1 të LDTHMP-së nga këndvështrimi i administrimit të mirëfilltë të drejtësisë është dashur që në rastin konkret të kenë parasysh: (i) rrethanat specifike të rastit të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht të kenë parasysh faktin që Vendimi për shkëputjen e marrëdhënies së punës, i 17 qershorit 2004 dhe Vendimi i organit të shkallës së dytë, i 26 janarit 2005 të Punëdhënësit ishin bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 dhe ky i fundit nuk përmbante këshillë juridike; (ii) se procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta kishin zgjatur më shumë se pesëmbëdhjetë (15) vite nga parashtrimi i kërkesëpadisë së tij në Gjykatën Komunale dhe se përgjatë këtyre procedurave rasti i tij ishte shqyrtuar si për nga lejueshmëria ashtu edhe për nga meritat e kërkesëpadisë; (iii) se lejueshmëria e kësaj kërkesëpadie në aspekt të afatit kohor, përkatësisht aplikueshmëria e LDTHMP-së nuk ishte ngritur deri në nxjerrjen e Aktvendimit [Ac.nr.2980/2016] të 19 majit 2020 të Gjykatës së Apelit; dhe si rezultat i këtyre të fundit (iv) është dashur që të mënjanojnë formalizmin e tepruar gjatë interpretimit të dispozitës përkatëse të LDTHMP-së në rrethanat e parashtruesit të kërkesës.

86. Si rezultat i të lartcekurave, Gjykata gjen se si rezultat i interpretimit formalist dhe aplikimit të paragrafit 1 të nenit 83 të LDTHMP-së, konstatimi i tyre në lidhje me afatshmërinë e kërkesëpadisë ka pushur të jetë në shërbim të parimit të sigurisë juridike, i cili për pasojë ka cenuar të "drejtën e qasjes" së parashtruesit të kërkesës në gjykatë.

87. Në vijim të kësaj, Gjykata thekson se interpretimi dhe zbatimi i dispozitave të LDTHMP-së, të vitit 1989 nga ana e Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme në rrethanat e parashtruesit të kërkesës nuk është proporcional me qëllimin e ndjekur për garantimin e sigurisë juridike dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, si një ndër parimet bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike.

88. Prandaj, bazuar në si më sipër, Gjykata konsideron se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme duke interpretuar dhe aplikuar paragrafin 1 të nenit 83 të LDTHMP-së, të vitit 1989, parashtruesit të kërkesës: (i) ia mohuan "të drejtën e qasjes në gjykatë" në kuptim të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; dhe (ii) për pasojë i pamundësuan atij që rasti i tij të vazhdojë të shqyrtohet në meritat e kërkesës.

89. Përfundimisht, Gjykata konstaton se konstatimi i Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme përmes aktvendimeve të lartcekura për hedhje të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës si të pasaftshme janë nxjerrë në shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Aktvendimi [Rev.nr.393/2020] i 1 shkurtit 2021, i Gjykatës Supreme nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

90. Në vijim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij kishte pretenduar edhe shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjet Juridike] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Në lidhje më këtë, ashtu siç është elaboruar edhe më lart, Gjykata konstatoi se rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës ngërthejnë elemente që ndërlidhen me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, si një ndër parimet e garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe në vijim të kësaj pas elaborimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të tij dhe procedurës së zhvilluar para gjykatave të rregullta konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka cenuar të drejtën e tij për qasje në gjykatë. Rrjedhimisht, si rezultat i këtij konstatimi, Gjykata nuk e vlerëson si të nevojshme të shqyrtojë ndaras pretendimet për shkelje të të drejtave te garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës.

Përfundime

91. Gjykata ka trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, dhe me gjithë faktin që parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij kishte pretenduar shkelje të nenit 32 dhe nenit 54 të Kushtetutës, konstatoi se rrethanat e rastit konkret ngërthejnë elemente që ndërlidhen me pretendim të shkeljes së të drejtës së tij për qasje në gjykatë, si një nga parimet e garantuara në paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Gjykata në vijim, dhe me qëllim të vlerësimit dhe shqyrtimit të këtij pretendimi ka aplikuar për vlerësim, praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës.

92. Gjykata, pas elaborimit dhe shqyrtimit të procedurës së zhvilluar dhe arsyetimit të vendimeve të gjykatave të rregullta, përkatësisht të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, konstatoi se: (i) interpretimi tejet formalist dhe konstatimi në lidhje me aplikueshmërinë e paragrafit 1 të nenit 83 të LDTHMP-së në rrethanat e parashtruesit të kërkesës dhe konstatimi i tyre se kërkesëpadia e tij është e pasafatshme përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme në rrethanat e parashtruesit të kërkesës nuk është proporcional me qëllimin e ndjekur për garantimin e sigurisë juridike dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, si një ndër parimet bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike; (ii) si rezultat i këtij interpretimi dhe konstatimi të Gjykatës Supreme, përmes Aktvendimit të saj të kontestuar parashtruesit të kërkesës i është mohuar "e drejta e tij e qasjes në gjykatë" në kuptim të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së duke i pamundësuar atij që rasti i tij të vazhdojë të shqyrtohet në meritat e kërkesës.

93. Përfundimisht, Gjykata konstatoi se Aktvendimi i kontestuar [Rev.nr.393/2020] i 1 shkurtit 2021, i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 31, paragrafin 1 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së.

94. Në fund, Gjykata si rezultat i konstatimit të saj për shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 31, paragrafin 1 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së nuk e vlerësoi si të nevojshme të shqyrtojë ndaras pretendimet për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 nëntor 2021, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se Aktvendimi [Rev.nr.393/2020] i 1 shkurtit 2021, i Gjykatës Supreme nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm, Aktvendimin [Rev.nr.393/2020] të 1 shkurtit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës;

IV. TË KTHEJË Aktvendimin [Rev.nr.393/2020] të 1 shkurtit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës, për rivendosje në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më 4 maj 2022, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;

VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Remzije Istrefi-Peci	Gresa Caka-Nimani

KI143/21, Parashtrues: Avdyl Bajgora, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. 558/2020, të 22 shkurtit 2020

KI143/21, Aktgjykim i 25 nëntor 2021, publikuar më 14 dhjetor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për qasje në gjykatë, kërkesë e pranueshme, shkelje e së drejtës për gjykim të drejtë.*

Çështja kryesore që ngërthen ky rast ka të bëjë me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, ushtruar kundër ndërmarrjes publike KEK, për kompensimin e tri pagave jubilare dhe pagesën e diferencës në pagë, për tri paga përcjellëse të pensionimit, bazuar në nenin 52, paragrafi 1, pika 3, dhe nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, e cila ishte ne fuqi nga 1 janari 2015, deri me 1 janar 2018. Gjykata Themelore në Prishtinë kishte (i) aprovuar kërkesëpadinë përkatëse për pjesën që kishte të bënte me kompensimin e tri pagave jubilare në shumën prej 2,739.00 euro; ndërsa (ii) kishte refuzuar kërkesëpadinë në pjesën që kishte të bënte me pagesën e diferencës në pagë në shumën prej 547,80 euro. Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas ankesës së KEK-ut, kishte ndryshuar Aktgjykimin e shkallës së parë dhe duke iu referuar dispozitave përkatëse që ndërlidheshin me parashkrimin, kishte refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Në shqyrtimin e kërkesës për revizion të këtij të fundit, Gjykata Supreme kishte konstatuar se revizioni në këtë rast nuk është i lejuar, sepse vlera e kontestit nuk e kalonte shumën prej 3,000.00, siç është përcaktuar në dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Duke kontestuar konstatimin e Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese pretendoi shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si pasojë e cenimit të parimit për qasje në gjykatë dhe gjithashtu të drejtës për mjete efektive juridike dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave, siç janë të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në esencë, parashtruesi i kërkesës pretendoi para Gjykatës, që Gjykata Supreme kishte refuzuar kërkesën e tij për revizion duke vlerësuar gabimisht shumën e kontestit.

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht (i) shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me parimin e *"qasjes në gjykatë";* dhe (ii) më pas, i aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata, ndër tjerash, rikujtoi se, në parim, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, nuk reflekton vetëm të drejtën për të filluar procedura, por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të kontestit përkatës nga një gjykatë.

Gjykata, pasi analizoi shkresat e lëndës, konsideroi se vlera e objektit të kontestit duhet të marrë parasysh shkaktimin e dëmit të tërësishëm dhe që vlerësimi i vlerës së dëmit për qëllime të lejueshmërisë së mjetit juridik nuk mund të i nënshtrohet një qasje tejet formaliste, ndërsa në rrethanat e rastit konkret, vlera e kontestit ishte dukshëm mbi vlerën në bazë të të cilës është i lejuar revizioni. Gjykata më tej dhe bazuar në sqarimet e dhënë në Aktgjykimin e publikuar, theksoi se mospranimi i shqyrtimit të kërkesës së parashtruesit përkatës në merita nga ana e Gjykatës Supreme, përbën një të metë procedurale të pakapërcyeshme e cila është në kundërshtim me të drejtën për qasje në gjykatë si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm.

Për pasojë dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar [Rev. nr. 558/2020] i 22 shkurtit 2020 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe rrjedhimisht, shpalli të njëjtin të pavlefshëm duke e kthyer në rivendosje në pajtueshmëri me konstatimet e Gjykatës Kushtetuese.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI143/21

Parashtrues

Avdyl Bajgora

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. 558/2020, të 22 shkurtit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Avdyl Bajgora (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prishtinë, i cili përfaqësohet nga Jeton Osmani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit Rev. nr. 558/2020 të Gjykatës Supreme të 22 shkurtit 2020, në ndërlidhje me Aktgjykimin Ac. nr. 5071/2019 të Gjykatës së Apelit të 17 janarit 2020.

3. Aktvendimi i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 8 prill 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin

parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNj), nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], në lidhje me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetua) dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNj-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 7 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Postën e Republikës së Kosovës.

7. Më 8 gusht 2021, kërkesa u regjistrua në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 19 gusht 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

9. Më 9 shtator 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës, në pajtim me Ligjin, iu dërgua Gjykatës Supreme.

10. Më 9 shtator 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë informata lidhur me datën e pranimit të aktvendimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.

11. Më 14 shtator 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë informoi Gjykatën se Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 8 prill 2021.

12. Më 15 tetor 2021, Gjykata ia kërkoi Gjykatës Themelore në Prishtinë dosjen e lëndës.

13. Më 20 tetor 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës.

14. Më 25 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, të deklarojë kërkesën të pranueshme për shqyrtim dhe të konstatojë shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së.

Përmbledhja e fakteve të rastit

15. Parashtruesi i kërkesës që nga viti 1975 ka punuar në ndërmarrjen publike Korporata Energjetike e Kosovës Sh. A. (në tekstin e mëtejmë: ndërmarrja publike KEK), deri në arritjen e moshës së pensionimit, respektivisht deri më 29 maj 2018.

16. Më 10 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për dhënien e tri pagave jubilare në ndërmarrjen publike KEK bazuar në nenin 52, paragrafi 1, pika (3) të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, e cila ishte në fuqi prej 1 janarit 2015, deri më 1 janar 2018. Në kërkesë theksohet: *"Konsideroj se kërkesa ime është më se e arsyeshme dhe e bazuar nga arsyet se shpërblimi jubilar është dashur të paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf nga vetë punëdhënësi, pa pasur nevojë fare që të bëhet kërkesë (neni 52 parag.3) i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive"*.

17. Më 14 dhjetor 2018, ndërmarrja publike KEK, nëpërmjet shkresës nr. 1527, refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shpërblimin e tri pagave jubilare, me arsyetimin se: *"E drejta në shpërblim jubilar nuk është përcaktuar me Ligj dhe se këtë të drejtë e parasheh Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive dhe Kodi ynë i Punës, por jo si të drejtë imperative"*.

18. Më 24 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar nga Gjykata që ta detyroj të padituren (ndërmarrja publike KEK), që t'ia paguajë paditësit (parashtruesit të kërkesës) një shumë të pacaktuar në emër të tri pagave jubilare dhe në emër të diferencës së pagës dhe të shtesës për përvojë për tri paga pensionimi, shumat që do të përcaktohen pas ekspertizës financiare, së bashku me interesin ligjor. Paditësi e bazoi kërkesën e tij në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës,

përkatësisht në nenin 52, paragrafi 3 dhe në nenet 44 dhe 48 të Marrëveshjes, duke marrë parasysh se paditësi ka punuar si kryeinxhinier për realizimin e projekteve mekanike dhe ka më shumë se 40 vjet përvojë pune.

19. Ndërmarrja Publike KEK (e paditura), parashtroi përgjigje në kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke e kontestuar në tërësi çështjen e kërkuar në kërkesëpadi, me pretendimin se e njëjta është parashkruar.

20. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës, në cilësi të paditësit, përmes të autorizuarit të tij ka saktësuar kërkesëpadinë duke u bazuar në pagën e fundit të marrë nga e paditura (ndërmarrja publike KEK) para parashtrimit të padisë, kështu që ka kërkuar shumën prej 2,739.00 € në emër të tri pagave jubilare dhe në emër të diferencës shumën prej 547,80 €, në vlerë të përgjithshme prej 3,286.80 €. Ai shtoi gjithashtu se meqenëse paditësi kishte punuar për të padituren për më shumë se 40 vjet dhe meqenëse çështja e kompensimit të pagave jubilare nuk ishte e rregulluar për këtë kategori, por pasi me asnjë dispozitë tjetër nuk ndalohej shpërblimi i pagës për moshën 40 vjeçare sepse nuk konsiderohet si vit jubilar, konsideroi se duhet të zbatohet dispozita më e përafërt ligjore, që është neni 52, paragrafi 3, i MPKK-së.

21. Më 7 maj 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 3845/18, I. aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, II. detyroi të padituren (ndërmarrjen publike KEK) që t'i paguajë parashtruesit të kërkesës shumën prej 2,739.00 €, në emër të tri pagave jubilare, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga pranimi i këtij aktgjykimi, III. ka refuzuar një pjesë të kërkesëpadisë lidhur me diferencën në pagë në shumën prej 547,80 €, dhe IV. ka obliguar të padituren (ndërmarrjen publike KEK), që t'ia paguaj parashtruesit të kërkesës shumën prej 260 €, në emër të shpenzimeve gjyqësore.

22. Gjykata Themelore në Prishtinë, ndër të tjera, vlerësoi se e paditura pas fitimit të përvojës së nevojshme të punës, ishte e detyruar t'i paguante paditësit tri paga jubilare, dhe konstatoi se kërkesëpadia e parashtruesit ishte e bazuar në lidhje me tri pagat jubilare dhe e pabazuar përkitazi me diferencën në paga, duke arsyetuar;

> *"... Gjykata duke ju referuar MPKK-së, konkretisht nenit 52, gjeti se e njëjta është e aplikueshme në rastin konkret dhe se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit t'ia paguaj tri paga në emër të shpërblimit jubilar në shumën prej 2,739.00 €, dhe jo edhe*

shumën e kërkuar për, I pagesën e diferencës së pagës në, emër të shtesës për përvojë për tri paga të pensionimit.
[...]
Siç shihet nga të gjitha provat e administruara më lart rezulton, se paditësi nuk e ka argumentuar me prova të mjaftueshme lartësinë e kërkesëpadisë së precizuar për pagesa në diferencën e pagës në emër të shtesës për përvojë për tri paga të pensionimit në shumë prej 547.80 €, dhe për këtë arsye gjykata nuk ka mundur- të vërtetoj lartësinë e kësaj kërkese dhe aplikoi rregullat mbi barrën e provës. Andaj, pala që pretendon që i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, sipas dispozitës ligjore të nenit 322 të LPK-së ...".

23. Në një datë të paspecifikuar, e paditura (ndërmarrja publike KEK) parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 7 majit 2019, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që kërkesëpadia të refuzohet në tërësi si e parashkruar.

24. Parashtruesi i kërkesës kundër ankesës së të paditurës (ndërmarrjes publike KEK) dorëzoi përgjigje në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet së cilës kërkoi të refuzohej në tërësi ankesa e të paditurës (ndërmarrjes publike KEK), të ndryshohej Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i 7 majit 2019, në pikën III të dispozitivit, ashtu që gjykata të miratojë si të bazuar kërkesëpadinë lidhur me diferencën në pagë në lartësi prej 547,80 €. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi që aktgjykimi të ndryshohej në pjesën e IV të dispozitivit lidhur me shpenzimet e procedurës, duke ia shtuar vlerës së aprovuar prej 260 €, nga shkalla e parë edhe shpenzimet e procedurës pranë Gjykatës së Apelit, në vlerën prej 208 €, e në total vlerën prej 468 €.

25. Më 17 janar 2020, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin Ac. nr. 5071/2019, aprovoi ankesën e të paditurës (ndërmarrjes publike KEK) dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 7 majit 2019, në pikën I. II dhe IV të dispozitivit, duke refuzuar kësisoj kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në pikat I. II dhe IV të dispozitivit dhe duke e lënë në fuqi Aktgjykimin Gjykatës Themelore në Prishtinë, në pikën III të dispozitivit me të cilën më herët ishte refuzuar kërkesëpadia përkitazi me diferencën në pagë në shumën prej 547,80 €. Kësisoj, në esencë pas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit u refuzua kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës në tërësi në shumën e përgjithshme prej 3,286.80 €.

26. Parashtruesi i kërkesës, brenda afatit ligjor, ushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të 17 janarit 2020, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, me pretendimin se Gjykata e Apelit nuk ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike dhe nuk ka zbatuar ligjin e aplikueshëm (Ligjin e Punës) dhe po ashtu Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive, kur ka vendosur ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë, duke u thirrur në përshkrimin e së drejtës së kërkuar me kërkesëpadi.

27. Më 22 shkurt 2022, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin Rev. nr. 558/2020, me të cilin, hedhë poshtë si të palejuar kërkesën për revizion, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke arsyetuar se në bazë të nenit 211.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit duhet të jetë mbi shumën prej 3000 €, në mënyrë që të lejohet revizioni.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të KEDNj-së, nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], në lidhje me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNj-së.

i. Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së

29. Në veçanti, parashtruesi i kërkesës pretendon se konstatimi i Gjykatës Supreme se kërkesa për revizion është e palejuar është i pabazuar, i papranueshëm dhe rrjedhimisht i kundërligjshëm dhe bie ndesh me kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së, për arsye se mosvendosja në merita të rastit, gjegjësisht hedhja e kërkesës për revizion në kundërshtim me nenin 211 të LPK-së, ka bërë që vendimmarrja e kësaj gjykate të rezultojë me shkeljen e së drejtës së tij për gjykim të drejtë, e cila garantohet me nenin 31 të Kushtetutës.

30. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson se është i pakontestueshëm fakti se në rastin e tij është cenuar jo vetëm parimi i administrimit të drejtësisë, por edhe barazia e armëve, e cila ka konsistuar më pas në pamundësinë e shfrytëzimit në mënyrë efektive të mjetit juridik në

Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme, sipas parashtruesit të kërkesës, gabimisht ka vlerësuar se nuk kemi të bëjmë me kontest civil mbi vlerën 3000 € dhe se nuk është e lejuar kërkesa për revizion në këtë rast, sepse me Aktgjykimin Ac. nr. 5071/2019 të Gjykatës së Apelit të 17 janarit 2020 është ndryshuar në tërësi Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 3845/18, i 7 majit 2019. Prandaj, duke qenë se Gjykata e Apelit e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e tij, nënkupton se vlera e kontestit, siç është precizuar në dispozitivin e Aktgjykimit Ac. nr. 5070/2029 të Gjykatës së Apelit ishte 3,286.80 €. Andaj, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme është dashur të vendosë për tërë kërkesëpadinë, pasi që me refuzimin e tërësishëm të kërkesëpadisë nga Gjykata e Apelit, kontesti është kthyer në pikën zero, vlera e të cilit është shuma e tërësishme prej 3,286.80 € dhe jo shuma prej 2793,00 €, siç ka konsideruar Gjykata Supreme.

31. Mbi këtë bazë, parashtruesi i kërkesës pretendon se është vënë në pozitë të pafavorshme përballë të padituës në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve, i cili përcakton se secila palë në procedurë, duhet të ketë mundësinë e arsyeshme për të paraqitur rastin e vet në kushte që nuk e vënë atë në pozitë të pafavorshme përballë kundërshtarit të vet.

32. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, me të cilin është refuzuar në tërësi kërkesëpadia e tij, është marrë në kundërshtim me gjendjen faktike dhe me zbatimin e ligjit të gabuar material, dhe se në rastin konkret fare nuk u morën parasysh aktet e brendshme të të padituës me të cilat ishte vazhduar dhënia e shpërblimit jubilar. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se kërkesëpadia e tij nuk është parashkruar dhe se e njëjta është e afatshme në kuptim të Ligjit të punës dhe të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, sepse të drejtën e shpërblimit jubilar, për tri paga jubilare e kishte fituar gjatë kohës sa ishte ende në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive dhe se kërkesën për shpërblim jubilar e kishte parashtruar brenda afatit të paraparë me nenin 87 të Ligjit të punës, dhe atë pasi që kishte plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 52.1.3 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, përkatësisht pasi që kishte mbushur 40 (dyzetë) vjet të përvojës së punës tek punëdhënësi. Parashtruesi tutje thekson se meqë e paditura ndërmarrja publike KEK nuk ia kishte paguar tri paga, në emër të shpërblimit jubilar, të cilat ligjërisht i takonin, ai brenda afatit ligjor kishte ushtruar kërkesëpadi në gjykatën e shkallës së parë. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se kërkesa e tij për t'ia paguar tri paga, në emër të shpërblimit jubilar është e bazuar po ashtu në nenin 53.4 të Kodit të punës dhe në Vendimin nr. 2244 të ndërmarrjes publike KEK, të 10 prillit 2019 dhe plotësimin e tij me Vendimin nr.

8261, më 23 gusht 2019 nga ndërmarrja publike KEK me të cilin ishte vazhduar dhënia e shpërblimit jubilar, deri më 31 dhjetor 2019.

33. Andaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se kërkesa për shpërblim jubilar për tri pagat jubilare që është kërkuar me kërkesëpadi është brenda afateve ligjore, sepse të drejtën e shpërblimit e ka fituar në kohën sa ishte në zbatim Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, ndërsa afati për paraqitjen e kërkesave monetare ka vazhduar edhe për 3 vite tjera, sipas nenit 87 të Ligjit të punës. Parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtën e shpërblimit e gëzon edhe në kuptim të nenit 193 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), pasi që sipas këtij neni, në rastin e tij kemi të bëjmë me pasurim të pabazë, meqenëse e paditura duke ia mohuar të drejtën e tij për shpërblim jubilar, e ka dëmtuar atë, duke ia ndalur pa bazë ligjore shumën e precizuar në kërkesëpadi.

34. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit kanë vendosur për raste në rrethana tërësisht të ngjashme faktike dhe juridike sikurse të tij, duke aprovuar kërkesëpaditë e punëtorëve të së padituës ndërmarrja publike KEK, prandaj parashtruesi i kërkesës pretendon se është vënë në pozitë të pabarabartë para ligjit. Parashtruesi më tutje argumenton se neni 31 i Kushtetutës thekson, çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike

35. Në mbështetje të këtij pretendimi parashtruesi i kërkesës ia ka bashkëngjitur kërkesës aktgjykimet e Gjykatës Supreme, CML. nr. 7/2020 të 15 prillit 2021 dhe Rev. nr. 90/2020 të 4 majit 2020, si dhe aktgjykimet e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 4367/2020 të 17 korrikut 2020 dhe Ac. nr. 2016/2020 të 24 qershorit 2020. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ekzistojnë dhe qindra aktgjykime të tilla, në të cilat Gjykata e Apelit ua ka njohur këto të drejta paditësve në kushte dhe rrethana të njëjta faktike dhe juridike sikurse të tij.

ii. Pretendimet për shkelje të nenit 32, në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës, si dhe nenin 13 të KEDNj-së

36. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me këto pretendime, thekson se Gjykata Supreme duke hedhur poshtë si të palejuar revizionin, në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, gjegjësisht me nenin 211 të LPK-së, ka shkelur të drejtat e tij për mjete efektive juridike të garantuara me nenin 32, në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës, sepse atij i është pamundësuar mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe shqyrtimi i meritave të rastit.

iii. Përkitazi me shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës

37. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson, nisur nga fakti që gjykatat e rregullta për çështje të ngjashme kanë dalë me qëndrime të ndryshme, ai është diskriminuar në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës, sepse është vënë në pozitë të pabarabartë me paditësit tjerë që u janë aprovuar kërkesëpaditë në kushte të ngjashme. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta kanë shkelur edhe nenin 102 të Kushtetutës, duke mos vepruar dhe vendosur në bazë të ligjit të aplikueshëm dhe siç kërkohet me Kushtetutë.

Dispozitat relevante

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 211

211.1 Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi.

211.2 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 €.
(...)

LIGJI NR.03/L-212 I PUNËS

Neni 87
[Afati i parashkrimit]

Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

Neni 193
E drejta e të dëmtuarit pas parashkrimit të së drejtës për të kërkuar shpërblimin

Pas parashkrimit të së drejtës për të kërkuar shpërblimin e dëmit i dëmtuari mund të kërkojë nga personi përgjegjës, sipas rregullave që vlejnë në rastin e pasurimit të pabazë, që t'i cedojë atë që ka marrë nga veprimi me të cilin është shkaktuar dëmi.

MARRËVESHJEN E PËRGJITHSHME KOLEKTIVE TË KOSOVËS

Neni 3
Aplikimi dhe përfshirja

Dispozitat e MPKK-së aplikohen në tërë territorin e Republikës së Kosovës

Neni 52
Shpërblime jubilare

1. I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë:
1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij;
1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy pagave mujore të tij;

1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri pagave mujore të tij.
2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilare.
3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.

Neni 53
Kompensimi në rast të pensionimit

I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit.

Vendimi nr. nr. 8261 i KEK-Sh. A., i nxjerrë më 24 gusht 2019

Vendim

I. Vazhdohet njohja e obligimit për pagesën e pagave jubilare për të gjithë punëmarrësit që kanë plotësuar kushtin deri më 31.12.2019, pra që kanë arritur përvojën e punës 10, 20 apo 30 vite, prej 01.01.2015 dhe në vazhdimësi.
(...)

III. Punëmarrësit të cilët kanë arritur përvojën e punës 40 vite gëzojnë këtë të drejtë njëjtë sikurse punëtorët që kanë arritur përvojën e punës 30 vite.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

[...]

40. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...".

41. Përkitazi me përmbushjen e kritereve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: i. është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ii. ai konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit Rev. nr. 558/2020 të Gjykatës Supreme, të 22 shkurtit 2020; iii. ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; iv. ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe v. kërkesën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç përcakton neni 49 i Ligjit.

42. Megjithatë, përveç kësaj Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me dispozitat (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

(1) "Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:
(...)
(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

43. Gjykata konsideron se kërkesa ngre pretendime serioze kushtetuese të arsyetuara *prima facie* dhe se ajo nuk është qartazi e pabazuar në

kuptim të rregullit 39 (2) të Rregullores. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i përmbush kushtet për vlerësim në merita.

Meritat e kërkesës

44. Fillimisht, Gjykata përsërit se kërkesa e nenit 53 të Kushtetutës përcakton që interpretimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë të jetë në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNj).

45. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit Rev. nr. 558/2020 të Gjykatës Supreme, të 22 shkurtit 2020, duke pretenduar në shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, nenin 32 [E Drejta për Mjete Efektive Juridike], në lidhje me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNj-së.

Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së

46. Në vazhdim, Gjykata do të analizojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për "gjykim të drejtë" në harmoni me jurisprudencën e GJEDNj-së dhe të vetë Gjykatës.

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet dispozitave të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së, që përcaktojnë:

Neni 31
[E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. "Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".
[...]

Neni 6.1
(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1."Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme".

[...]

48. Gjykata bazuar në shkresat e lëndës vëren se esenca e pretendimeve për shkeljen e të drejtave kushtetuese me Aktvendimin e kontestuar [Rev. nr. 558/2020] të Gjykatës Supreme, ndërlidhet me mohimin e të drejtës për qasje në gjykatë, që pretendohet të jetë shkaktuar nga konkluzionet arbitrare të Gjykatës Supreme, duke konsideruar se vlera e objektit të kontestit, në pjesën e goditur të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, nuk e ka kaluar vlerën prej 3,000.00 €.

49. Nga një konstatim i tillë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme me hedhjen poshtë të kërkesës për revizion, ia ka pamundësuar atij shqyrtimin e çështjes në merita (qasjen në gjykatë), kundër shkeljeve të shkaktuara nga Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ac. nr. 5070/2020, të 17 janarit 2020.

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për "qasje në gjykatë"

50. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se e drejta për të pasur qasje në gjykatë për qëllime të nenit 6.1 të KEDNj-së është qartësuar në rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* (shih rastin e GJEDNJ-së, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 21 shkurtit 1975, paragrafët 28-36). Duke iu referuar parimit të sundimit të ligjit dhe shmangies së pushtetit arbitrar, GJEDNj-ja ka konstatuar se "e drejta për qasje në gjykatë" është aspekt thelbësor i garancive procedurale të mishëruara në nenin 6 të KEDNj-së. (Përkitazi me parimet e përgjithshme të së drejtës në gjykatë, shih gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNj-së të 31 dhjetorit 2018 për nenin 6 të KEDNJ-së, e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, Pjesën II, E drejta në Gjykatë dhe gjithashtu, ndër të tjera, rastin e GJEDNj-së, *Zubac kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 5 prillit 2018, paragrafi 76). Për më tepër, sipas GJEDNj-së, kjo e drejtë i siguron çdokujt të drejtën e adresimit të çështjes përkatëse që ndërlidhet me "të drejta dhe detyrime civile" para një gjykate (shih rastin e GJEDNj-së, *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84 dhe referencat në të).

51. Gjykata në këtë kontekst thekson se e drejta në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, përcakton që ndërgjyqësit duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih rastet e GJEDNJ-së, *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke,* Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 49; dhe *Naït-Liman kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 112).

52. Rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, çdokush ka të drejtë që të paraqesë "padi" lidhur me të "drejtat dhe detyrimet civile" përkatëse tek një gjykatë. Neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së mishërojnë të "drejtën për gjykatë", përkatësisht të "drejtën e qasjes në gjykatë", e që nënkupton të drejtën për të filluar procedurat tek gjykatat në çështjet civile (shih rastin e GJEDNJ-së *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 36). Prandaj, çdokush që konsideron se ka pasur ndërhyrje të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtave civile të tij/saj dhe pretendon se i është kufizuar mundësia për të kontestuar një pretendim të tillë para një gjykate, mund t'i referohet nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, duke u thirrur në të drejtën përkatëse për qasje në gjykatë.

53. Më specifikisht, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNj-së, së pari duhet të ekzistojë një "e drejtë civile" dhe së dyti, të ketë një "kontest" lidhur me ligjshmërinë e një ndërhyrje, që prek vetë ekzistencën apo fushëveprimin e "të drejtës civile" të mbrojtur. Definicioni i të dy këtyre koncepteve, duhet të jetë përmbajtësor dhe joformal (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së *Le Compte, Van Leuven and De Meyere kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 23 qershorit 1981, paragrafi 45; *Moreira de Azevedo kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 23 tetorit 1990, paragrafi 66; *Gorou kundër Greqisë* (nr.2), Aktgjykim i 20 marsit 2009, paragrafi 29; dhe *Boulois kundër Luksemburgut*, Aktgjykim i 3 prillit 2012, paragrafi 92). "Kontesti", megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të jetë (i) i "vërtetë dhe serioz" (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, paragrafi 81; dhe *Cipolletta kundër Italisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2018, paragrafi 31); dhe, (ii) rezultatet e procedurave para gjykatave duhet të jenë "vendimtare" për të drejtën civile në fjalë (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Ulyanov kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 5 tetorit 2010). Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, "lidhjet e paqëndrueshme" ose "pasojat e largëta" në mes të drejtës civile në fjalë dhe rezultatit të këtyre procedurave, nuk janë të mjaftueshme për të qenë në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së,

Lovrić kundër Kroacisë, Aktgjykim i 4 prillit 2017, paragrafi 51 dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 71 dhe referencat në të).

54. Në raste të tilla, kur është konstatuar të ketë një "të drejtë civile" dhe një "kontest", neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së i garantojnë individit të drejtën "që ajo çështje të zgjidhet nga një tribunal" (shih rastin e GJEDNj-së, *Z. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 10 majit 2001, paragrafi 92). Refuzimi i një gjykate për të shqyrtuar pretendimet e palëve lidhur me pajtueshmërinë e një procedure me garancitë procedurale themelore të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, kufizon qasjen e tyre në gjykatë (shih rastin e GJEDNJ-së *Al Dulimi dhe Montana Management Inc kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 21 qershorit 2016, paragrafi 131).

55. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNj-së, Konventa nuk synon të garantojë të drejta që janë "*teorike dhe të rreme*", por të drejta që janë "*praktike dhe efektive*" (shih, për më tepër rreth të drejtave "praktike dhe efektive", Udhëzuesin e GJEDNj-së të 31 dhjetorit 2018 për nenin 6 të KEDNj-së, E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, Pjesa II. E Drejta në Gjykatë, A. E Drejta dhe Qasja në Gjykatë, 1. Një e drejtë praktike dhe efektive; dhe rastet e GJEDNj-së *Kutić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 25 dhe referencat e cituara aty; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 86 dhe referencat në të).

56. Prandaj, në kuptim të këtyre të drejtave, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, garantojnë jo vetëm të drejtën për të filluar procedura, por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të "kontestit" përkatës nga një gjykatë (shih rastet e GJEDNj-së, *Kutić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 1 marsit 2002, paragrafët 25-32; *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 86 dhe referencat në të; *Aćimović kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 9 tetorit 2003, paragrafi 41; dhe *Beneficio Cappella Paolini kundër San Marinos*, Aktgjykim i 13 korrikut 2004, paragrafi 29).

57. Parimet e lartpërmendura, megjithatë, nuk nënkuptojnë që e drejta për gjykatë dhe e drejta e qasjes në gjykatë janë të drejta absolute. Ato mund të jenë subjekt i kufizimeve, të cilat janë qartë të përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNj-së (shih Udhëzuesin e GJEDNj-së të 31 dhjetorit 2018, për nenin 6 të KEDNj-së e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, dhe specifikisht përkitazi me kufizimet në të drejtën në gjykatë, Pjesën II. E drejta në Gjykatë, A. E drejta dhe në qasja në Gjykatë. 2. Kufizimet). Megjithatë, këto kufizime nuk mund

të shkojnë deri në atë masë sa të kufizojnë qasjen e individit ashtu që të cenohet vetë thelbi i të drejtës (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNj-së, *Baka kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 23 qershorit 2016, paragrafi 120; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 89 dhe referencat në të). Kurdo që qasja në gjykatë kufizohet nga ligji ose praktika përkatëse gjyqësore, Gjykata shqyrton nëse kufizimi prek thelbin e të drejtës dhe, në veçanti, nëse ky kufizim ka ndjekur një "qëllim legjitim" dhe nëse ekziston "një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet" (shih rastet e GJEDNj-së, *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Aktgjykim i 28 majit 1985, paragrafi 57*; Lupeni Greek Catholic Parish kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 89; *Naït-Liman kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafi 115; *Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Aktgjykim i 21 shtatorit 1990, paragrafi 65; dhe Marković dhe të tjerët kundër Italisë, Aktgjykim i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 99).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

58. Gjykata para se të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, përkatësisht për "qasje në drejtësi" dhe të shikimit të procedurës në tërësinë e saj, i referohet fillimisht Aktgjykimit [C. nr. 3845/18] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe vëren se parashtruesi i kërkesës, gjatë shqyrtimit gjyqësor e kishte precizuar kërkesëpadinë, duke kërkuar që në emër të tri pagave jubilare t'i kompensohej shuma prej 2,739.00 €, dhe në emër të diferencës së pagave përcjellëse të pensionit, t'i kompensohej shuma prej 547.80 € dhe shuma totale në vlerën monetare prej 3,286.80 €. Megjithatë, gjykata në fjalë kishte aprovuar kërkesëpadinë në pikën I. përkitazi shumën prej 2.739,00, me kamatë ligjore prej 8%; kishte refuzuar kërkesëpadinë në pikën III, përkitazi me diferencën e pagës në shumën prej 547,80 €, dhe kishte aprovuar kërkesëpadinë në pikën IV përkitazi me detyrimin e të padituës KEK-Sh. A., që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj parashtruesit të kërkesës shumën prej 260 €.

59. Tutje Gjykata vëren se Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [Ac. nr. 5071/2019] të 17 janarit 2020, e kishte refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar se: *"Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar i Gjykatës Themelore në Prishtinë..., me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që paditësit t'i paguaj tri paga në emër të shpërblimit jubilar është në kundërshtim me dispozitat ligjore, lidhur me zbatimin e gabuar të nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të*

Kosovës, pasi që kjo marrëveshje ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2015 me kohëzgjatje të zbatimit për tri vite përkatësisht deri me datën 01.01.2018, kur të njëjtës i ka skaduar afati i zbatimit përkatësisht i ka pushuar efekti juridik". Përfundimisht, Gjykata vëren se Gjykata Supreme me Aktvendimin [Rev. nr. 558/2020], e kishte hedhur poshtë, si të palejuar kërkesën për revizion të ushtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të 17 janarit 2020, duke arsyetuar se vlera e kontestit nuk e kalon shumën prej 3000 €, për t'u mundësuar ushtrimi i këtij mjeti juridik.

60. Andaj, nga përshkrimi i lartcekur, Gjykata rikujton edhe njëherë se esenca e pretendimeve për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, ndërlidhet me mohimin e të drejtës për qasje në gjykatë, si rrjedhojë edhe mohimin e mjetit efektiv juridik dhe të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave, të cilat pretendohet se janë shkaktuar nga konkluzionet arbitrare të Gjykatës Supreme, në lidhje me vlerësimin e vlerës së objektit të kontestit, si parakusht për të vlerësuar meritat e rastit.

61. Gjykata, bazuar në praktikën e GJEDNj-së dhe të saj, përsërit se çdokush që konsideron se ka pasur ndërhyrje të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtave civile të tij/saj dhe pretendon se i është kufizuar mundësia për të kontestuar një pretendim specifik para një gjykate, mund t'i referohet nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, duke u thirrur në të drejtën përkatëse për qasje në gjykatë.

62. Bazuar sa më sipër, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson se e drejta për qasje në gjykatë, në parim, është e garantuar përkitazi me "*kontestet"* në lidhje me një "*të drejtë civile*". Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se për të përcaktuar aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, duhet pasur parasysh se kemi të bëjmë me dy çështje esenciale, e para ndërlidhet me "*të drejtën civile*", ndërsa e dyta me ekzistencën e një "*kontesti*".

63. Për sa i përket kushtit të parë, Gjykata rikujton se objekti që parashtruesi i kërkesës e kishte kërkuar me kërkesëpadi në gjykatën e shkallës së parë është kërkesa për kompensimin e tri pagave jubilare, në emër të shpërblimit jubilar të arritjes së përvojës së punës dhe kompensimi i diferencës së pagës, për tri pagat përcjellëse të pensionimit. Andaj, Gjykata në dritën e rrethanave të rastit vlerëson se kërkesa për kompensim në të holla, bie në fushëveprimin e të drejtave dhe detyrimeve, nga marrëdhënia e punës dhe hyn në drejtat civile.

64. Ndërsa për sa i përket kushtit të dytë, Gjykata vlerëson se në rastin para nesh kemi të bëjmë me një "kontest", në mes të parashtruesit të kërkesës, si palë e dëmtuar dhe të ndërmarrjes publike KEK, si shkaktuese e dëmit, e cila pretendohet se ka një detyrim ligjor (obligim monetar) për të përmbushur, ndaj parashtruesit të kërkesës.

65. Andaj, meqë janë përmbushur që të dyja kushtet e mësipërme, Gjykata në vazhdim do të analizojë nëse Gjykata Supreme me rastin e hedhjes poshtë, si të palejuar, të kërkesës për revizion, ia ka mohuar parashtruesit të kërkesës të drejtën për "qasje në gjykatë" dhe zgjidhjen meritore të thelbit të çështjes.

66. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktvendimit të kontestuar [Rev. nr. 558/2020] dhe vëren se Gjykata Supreme konkluzionin për hedhje poshtë, si të palejuar, të kërkesës për revizion e kishte arsyetuar si në vijim: "*Duke marrë parasysh faktin se pala paditëse nuk ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë, as në pjesën refuzuese të tij, si në pikën tre (III) të dispozitivit, dhe derisa ankesë ka ushtruar vetëm pala e paditur, në këtë pjesë vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka mbetur i pa shqyrtuar, dhe paditësi derisa në këtë pjesë nuk ka ushtruar mjetin e rregullt-ankesën, nuk mund të ushtroj revizionin si mjet të jashtëzakonshëm, sa i përket kërkesës së refuzuar në emër të diferencës në shumë prej 547.80 €*".

67. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në parashtresën e tij dorëzuar Gjykatës së Apelit, shprehimisht ka kërkuar që të ndryshohej Aktgjykimi [C. nr. 3845/18] i Gjykatës Themelore në Prishtinë, në pikën III të dispozitivit, me arsyetimin se Gjykata Themelore në Prishtinë: "*... gabimisht ka vendosur që të refuzojë pjesën e kërkesëpadisë në emër të diferencës së pagës për shtesë, për tri paga përcjellëse për pensionim, e kjo pasi që e paditura me rastin e dhënies së tri pagave, me rastin e pensionimit e ka llogaritur vetëm pjesën e pagës bazë të paditësit, ndërsa është dashur që t'i llogarisë tri pagat mujore të cilat i ka marrë paditësi para pensionimit, bazuar në nenin 53 të MPPK-së. Andaj edhe nga këto arsye paditësi ka kërkuar që t'i njihet edhe e drejta në diferencën për tri paga përcjellëse në emër të pensionimit. Paditësi bazuar në shkresat e lëndës dhe thënieve të lartcekura si dhe deklarimeve gjatë seancave të mbajtura i propozon Gjykatës së Apelit që ankesën e paditësit ta REFUZOJ në tërësi si të pabazuar, ndërsa Aktgjykimin C.nr.3845/18 të datës 07.05.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ta ndryshoj në atë mënyrë që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe të ndryshoj edhe në pjesën e dispozitivit, lidhur me shpenzimet duke i njohur edhe*

shpenzimet për këtë përgjigje në ankesë në vlerën prej 208 €, në total t'i njeh në emër të shpenzimeve paditësit vlerën prej 468 €".

68. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk ka hequr dorë nga vlera prej 547,80 €, të cilën e ka kërkuar në emër të diferencës së pagës, së tri pagave përcjellëse të pensionimit, siç gabimisht ka theksuar Gjykata e Apelit në Aktgjykim të 17 janarit 2020, nga ku është bazuar dhe Gjykata Supreme. Parashtruesi i kërkesës ishte i qartë në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës së Apelit nga e cila ka kërkuar që ta refuzojë ankesën e të paditurës KEK-Sh.A., dhe të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e tij, që nënkupton se ka kërkuar të ndryshohej Aktgjykimi [C. nr. 3845/18] i Gjykatës Themelore në Prishtinë, në pikën III të dispozitivit, duke aprovuar diferencën e pagave në shumën prej 547,80 €, si dhe të ndryshohej aktgjykimi në fjalë edhe në pikën IV të dispozitivit, përkitazi me shpenzimet e procedurës, duke kërkuar që vlerës së aprovuar prej 260 €, nga shkalla e parë, t'i shtoheshin edhe shpenzimet e procedurës pranë Gjykatës së Apelit, në vlerën prej 208 €, dhe në tërësi të aprovohej vlera prej 468 €.

69. Gjykata për më tepër vëren se Gjykata Supreme në aktvendimin e saj, arsyetoi: *"...pavarësisht faktit se Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën dy, të dispozitivit të aktgjykimit, që të refuzojë kërkesëpadinë në emër të kërkesës për tri paga për shpërblim jubilar në shumën prej 2739,00 € dhe në emër të diferencës në shumën prej 547,80 €, në shumë të përgjithshme* ***prej 3,286.80 €,*** *kjo nuk e ndryshon vlerën e kontestit që mund të goditet me revizion, pasi objekti i revizionit mund të jetë vetëm kërkesa për tri paga për shpërblim jubilar në shumën prej 2739.00€, në të cilën pjesë revizioni është i palejuar, për shkak të vlerës së kërkesës, e cila është goditur me revizion, e cila është në shumën prej vetëm 2739.00 €".*

70. Gjykata, para se të arrijë në konstatimin e saj, rikujton përmbajtjen e nenit 211.2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, që përcakton: *"211.2 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 €".*

71. Nga leximi i normës është e qartë se vlera e objektit të kontestit, në pjesën e goditur të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, precizohet nga pala e dëmtuar, nëpërmjet ushtrimit të revizionit. Pra, është e drejtë diskrecionale e palës së dëmtuar të vendosë nëse dëshiron ta atakojë pjesërisht ose në tërësi aktgjykimin e shkallës së dytë, nëpërmjet ushtrimit të revizionit në Gjykatën Supreme.

72. Gjykata në vazhdim i referohet dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, i cili përcakton: *"REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit...me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësit në emër të tri pagave për shpërblim jubilar t'i paguaj shumën prej 2,739.00 euro, dhe në emër të diferencës në shumën prej 547.80 euro, në shumë të përgjithshme prej 3,286.80 euro dhe shpenzimet e procedurës, ne afat prej 7 ditësh, pas pranimit të aktgjykimit ...".*

73. Në rastin konkret, qartazi vërehet se parashtruesi i kërkesës e ka atakuar në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, me të cilin u refuzua në tërësi kërkesëpadia e tij. Rrjedhimisht atij i është refuzuar, vlera e tërësishme prej 3,286.80 €, e kërkuar me kërkesëpadi, që në rastin konkret përbën vlerën e objektit të kontestit në kuptim të nenit 211.2 të LPK-së.

74. Në këtë kontekst, Gjykata duke iu referuar po ashtu kërkesës për revizion, vëren se parashtruesi i kërkesës ka atakuar në të gjitha pikat e dispozitivit Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, me të cilin u refuzua vlera e tërësishme prej 3,286.80 €, e cila përfshin edhe pagesën e diferencës në pagë, në vlerën prej 547,80 €, por që në kuptim të vlerësimit të vlerës së objektit të kontestit, nuk përmendet askund shifra prej 468 € e cila ishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën e Apelit, në emër të shpenzimeve të procedurës, e që në rastin konkret përbën po ashtu vlerë të objektit të kontestit të goditur me revizion. Në këtë kuptim, Gjykata gjen se vlera reale e objektit të kontestit (dëmi i pësuar) që është goditur me revizion, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në kuptim të nenit 211.2, të LPK-së, del të jetë shuma e tërësishme prej 3,694.80 €.

75. Për më tepër, vlera e objektit të kontestit duhet të marrë parasysh shkaktimin e dëmit të tërësishëm që mund t'i bëhet një parashtruesi në një proces gjyqësor dhe jo vetëm vlerën e miratuar në favorin e tij nga gjykata. Në këtë rast, Gjykata Supreme ka paragjykuar paraprakisht vendimmarrjen e shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, përkitazi me pikën III të dispozitivit, me të cilën u refuzua vlera prej 547,80 €, në emër të diferencës në pagë, duke konstatuar se kjo pikë nuk është kontestuar në Gjykatën e Apelit nga parashtruesi i kërkesës. Megjithatë, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës në vazhdimësi dhe përgjatë gjithë procedurës kishte kërkuar që të aprovohej kjo shumë, nga arsyet e cekura në parashtresë dorëzuar Gjykatës së Apelit. (shih më sipër, paragrafin 24 dhe 67 të këtij dokumenti).

76. Gjykata, konsideron se parashtruesi i kërkesës i ndodhur para rrethanave faktike dhe juridike të tilla, kishte pritje legjitime se kërkesa

për revizion do të pranohej dhe shqyrtohej në merita dhe se pretendimet e tij do të merrnin përgjigje të arsyetuar nga Gjykata Supreme.

77. Thënë këtë, Gjykata konsideron se konkluzionet e Gjykatës Supreme, për hedhjen poshtë si të palejuar të kërkesës për revizion, janë qartazi të pabazuara dhe dukshëm arbitrare, të cilat kanë rezultuar në pamundësinë e parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, dhe rrjedhimisht në mohimin e së drejtës për mjet efektiv juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

78. Gjykata përsërit se nuk është detyrë e saj të vlerësojë nëse gjykatat e rregullta kanë interpretuar dhe zbatuar drejtë rregulltat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale. Megjithatë, në rastet kur një pretendim ngrenë çështje kushtetuese, përkatësisht parregullsi të procesit gjyqësor, Gjykata është e detyruar të ndërhyjë dhe të riparojë shkeljet e shkaktuara nga gjykatat e rregullta, për t'i siguruar individit një gjykim të drejtë në pajtueshmëri me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së.

79. Duke iu referuar rrethanave të rastit konkret, Gjykata konstaton se mospranimi i shqyrtimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës në merita nga ana e Gjykatës Supreme përbën një të metë procedurale të pakapërcyeshme e cila është në kundërshtim me të drejtën për qasje në gjykatë.

80. Andaj nga analiza e mësipërme, Gjykata konkludon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, i 22 shkurtit 2020, shkel të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së.

81. Sa i perket pretendimeve tjera të parashtruesit të kërkesës, të cilat i kishte ngritur në kërkesë për revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, e të cilat ndërlidhën me parashikimin e së drejtës për të kërkuar kompensimin e pagave jubilare dhe të diferencës në pagat përcjellëse të pensionimit, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk mund t'i trajtojë në këtë fazë pasi që aktvendimi i kontestuar duhet të kthehet në rivendosje, në Gjykatën Supreme, ku pritet që e njëjta, në pajtueshmëri me konstatimet e Gjykatës Kushtetuese në këtë Aktgjykim, ta paranojë kërkesën për revizion dhe të shqyrtojë meritat e kërkesëpadisë, përkitazi me parashkrimin e së drejtës, bazuar në praktikën e saj gjyqësore.

82. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ia ka bashkëngjitur kërkesës se tij, disa vendime të Gjykatës Supreme,

gjegjësisht aktgjykimet, CML. nr. 7/2020 të 15 prillit 2021 dhe Rev. nr. 90/2020 të 4 majit 2020, si dhe aktgjykimet e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 4367/2020 të 17 korrikut 2020 dhe Ac. nr. 2016/2020 të 24 qershorit 2020, duke pretenduar se ekzistojnë dhe qindra aktgjykime të tilla, në të cilat Gjykata e Apelit ua ka njohur këto të drejta paditësve në kushte dhe rrethana të njëjta faktike dhe juridike sikurse të tij. Gjykata, pasi konstatoi se në rastin e parashtruesit të kërkesës ka pasur shkelje të neneve respektive të Kushtetutës dhe të KEDNj-së, nuk e konsideron të nevojshëm të shqyrtojë tutje pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me divergjencën e praktikës gjyqësore dhe barazinë para ligjit.

Përfundim

83. Si përmbledhje, Gjykata, duke u bazuar në analizën e mësipërme, konkludoi se Aktvendimi i kontestuar [Rev. nr. 558/2020] i Gjykatës Supreme i 22 shkurtit 2020, shkel të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113. 1 dhe 116. 1 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2021, njëzëri:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktvendimin [Rev. nr. 558/2020] të Gjykatës Supreme, të 22 shkurtit 2020 dhe KTHEN të njëjtin në rivendosje, në pajtim me konstatimet e Gjykatës në këtë Aktgjykim;

IV. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme, që të njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për

masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës, jo më larg se më 25 maj 2022;

V. MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtimit me këtë urdhër;

VI. URDHËRON që ky Aktgjykim t'u komunikohet palëve;

VII. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VIII. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Radomir Laban	Gresa Caka-Nimani

KI84/21, Parashtrues: Telekomi i Kosovës Sh.A., Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.12/20, të 20 janarit 2021

KI84/21, Aktgjykim i 24 nëntorit 2021, publikuar më 17 dhjetor 2021

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, parimi i "barazisë së armëve", procedurë përmbarimi, "juridiksion i plotë"*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me Marrëveshjen për Shërbimet Mbështetëse të Operatorit Virtual të Rrjetit Mobil (Marrëveshja), të lidhur në mes të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht Telekomit të Kosovës dhe Kompanisë "Dardafon", lidhur me ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile. Marrëveshja e lartcekur, kishte rezultuar në një kontest në mes të palëve dhe si pasojë, kompania "Dardafon" kishte iniciuar tri (3) procedura të ndryshme, si në vijim: (i) procedurën para Tribunalit të Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike Ndërkombëtare (ICC) lidhur me zgjidhjen e kontestit nga Marrëveshja e lartcekur, e cila kishte rezultuar në nxjerrjen e Vendimit përmes të cilit, ndër tjerash, detyrohej parashtruesi i kërkesës që kompanisë "Dardafon", t'i paguaj një shumë të caktuar parash për shkak të mos respektimit të Marrëveshjes; (ii) procedurën lidhur me njohjen e Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit të ICC-së, e cila kishte rezultuar në njohjen e këtij Vendimi nga Gjykata Themelore, vendim ky që ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe rrjedhimisht kishte arritur formën e prerë; si dhe (iii) procedura lidhur me përmbarimin e Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit të ICC-së.

Objekti i çështjes para Gjykatës ndërlidhet vetëm me procedurën e tretë, përkatësisht procedurën lidhur me përmbarimin e Vendimin e Tribunalit të Arbitrazhit të ICC-së. Kontesti në procedurë përmbarimore kishte filluar pasi parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar prapësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Urdhrit Përmbarimor të nxjerrë nga Përmbaruesi Privat pas kërkesës së kompanisë "Dardafon".

Kontestuese ndërmjet palëve në procedurat e zhvilluara para Gjykatës Themelore, ndër tjerash, ishte shuma e përgjithshme e borxhit kryesor, përkatësisht shuma e cila do të ishte objekt përmbarimi. Për pasojë, Gjykata Themelore kishte nxjerr një Konkluzion përmes të cilit detyroi kompaninë "Dardafon", që në afat prej tri (3) ditësh, të bëjë precizimin e propozimit për përmbarim përkitazi me shumën e përgjithshme të borxhit kryesor. Në përgjigje të konkluzionit të lartcekur, kompania "Dardafon" dorëzoi në Gjykatën Themelore plotësimin e propozimit për përmbarim dhe një ekspertizë vetanake. Këto dokumente, Gjykata ia kishte dorëzuar edhe parashtruesit i kërkesës dhe i cili i kishte pranuar më 6 korrik 2020, ndërsa

përgjigjen e tij në Gjykatë e kishte dorëzuar, të nesërmen përkatësisht, më 7 korrik.

Megjithatë, më 6 korrik 2020, Gjykata Themelore kishte nxjerrë vendimin e saj, duke refuzuar si të pabazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me shumën prej 24,684,003.15 euro, ndërsa kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin lidhur me shumën prej 315,99.85 euro. Kundër këtij Aktvendimi, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar ankesë në Gjykatën e Apelit me pretendimin se Gjykata Themelore, mes tjerash, nuk e kishte marrë fare për bazë parashtresën e tij, sepse Aktvendimi i Gjykatës Themelore ishte nxjerrë një ditë më herët, pra më 6 korrik 2020, pa pritur dhe pa e shqyrtuar përgjigjen e parashtruesit të kërkesës rreth precizimit të propozimit për përmbarim të kompanisë "Dardafon" dhe dokumenteve tjera, përfshirë ekspertizën, në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me ligj dhe në cenim të parimit të "barazisë së armëve" të garantuar me Kushtetutë. Gjykata e Apelit, e kishte refuzuar si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke mos adresuar pretendimin përkitazi me pamundësinë e deklarimit të parashtruesit të kërkesës rreth precizimit të propozimit për përmbarim të kompanisë "Dardafon". Zyra e Prokurorit të Shtetit kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Kjo e fundit gjithashtu e kishte refuzuar kërkesën si të pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Kushtetuese, ndër tjerash, pretendoi se vendimet e gjykatave të rregullta në procedurë përmbarimi ishin nxjerrë në shkelje të parimit të "barazisë së armëve" të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse (i) Gjykata Themelore i kishte mohuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës që të deklarohet lidhur me precizimin e borxhit të kompanisë "Dardafon" dhe dokumenteve e provave tjera shtesë, përfshirë ekspertizën, sepse Aktvendimi i Gjykatës Themelore ishte nxjerrë në ditën kur parashtruesi i kërkesës kishte pranuar dokumentet përkatëse dhe Gjykata nuk kishte pritur as një ditë për përgjigjen e parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) Gjykata e Apelit, nuk kishte adresuar fare pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me pretendimin për shkeljen e parimit të "barazisë së armëve".

Në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata, fillimisht shtjelloi parimet e praktikës së saj gjyqësore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkitazi me parimin e "barazisë së armëve" dhe më pas i aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata, ndër tjerash, rikujtoi se, sipas parimit të "barazisë së armëve", është e papranueshme që një palë në procedurë të paraqesë vërejtje apo komente para gjykatave të rregullta, të cilat kanë për qëllim që të ndikojnë në vendimmarrjen e gjykatës, pa dijeninë e palës tjetër apo pa i dhënë mundësi

palës tjetër të përgjigjet përkitazi me to. Gjykata po ashtu theksoi se, mangësitë procedurale në instancë të parë mund të përmirësohen nëpërmjet ankesës, me kusht që institucioni i cili vendos për ankesën përkatëse, të ketë "juridiksion të plotë" lidhur me rastin para saj.

Gjykata, pasi i analizoi shkresat e lëndës dhe siç është sqaruar detajisht në Aktgjykimin e publikuar gjeti se: (i) në cenim të parimit të "barazisë së armëve", Gjykata Themelore i kishte mohuar parashtruesit të kërkesës të drejtën që të deklarohet lidhur me parashtresën e kompanisë "Dardafon" përkitazi me precizimin e propozimit për përmbarim dhe dokumenteve e provave shtesë, kjo pasi që, Aktvendimi i Gjykatës Themelore, ishte nxjerrë po në ditën kur parashtruesi i kërkesës kishte pranuar dokumentet dhe pa pritur përgjigjen përkatëse të tij; dhe (ii) Gjykata Supreme, e veçanërisht Gjykata e Apelit, e cila edhe pse kishte "juridiksion të plotë" për të vendosur lidhur me rastin, duke përfshirë kompetencën për të korrigjuar të metat e procedurës së ndjekur në Gjykatën Themelore, kishin dështuar të adresojnë të njëjtat, duke mos rikuperuar për pasojë, cenimin e parimit të "barazisë së armëve".

Rrjedhimisht dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se, Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, janë nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke e kthyer të njëjtin për rivendosje në Gjykatën e Apelit, marrë parasysh që kjo e fundit, siç është sqaruar në Aktgjykim, ka "juridiksion të plotë" për të adresuar të metat procedurale të cilat kanë rezultat në kontestimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI84/21

Parashtrues

Telekomi i Kosovës Sh.A

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.12/20, të 20 janarit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Telekomi i Kosovës Sh.A., i përfaqësuar nga Sebahedin Ramaxhiku dhe Gazmend Nushi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme] CML.nr.12/20 të 20 janarit 2021, në ndërlidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës [në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit] Ac.nr.3610/20 të 8 tetorit 2020, dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore] PPP.nr.1486/19 të 6 korrikut 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin

pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme në mënyrë që të pezullohet menjëherë zbatimi i përmbarimit ndaj parashtruesit të kërkesës sipas Urdhrit Përmbarimor [P.nr. 491/19] të 15 korrikut 2019, të Përmbaruesit privat Ilir Mulhaxha (në tekstin e mëtejmë: Përmbaruesi privat), dhe Aktvendimit [PPP.nr. 1486/19] të 6 korrikut 2020, të Gjykatës Themelore; Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3610/20 të 8 tetorit 2020; e Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.12/20 të 20 janarit 2021.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 6 maj 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

8. Më 18 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

9. Më 21 maj 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë një kopje e kërkesës i është dërguar Gjykatës Supreme të Kosovës.

10. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës edhe kompaninë "Dardafon.net" L.L.C (në tekstin e mëtejmë: kompania "Dardafon"), në cilësinë e palës së interesuar, si dhe Përmbaruesin privat, dhe të cilët i njoftoi që komentet e tyre, nëse kanë, t'i paraqesin në Gjykatë, brenda afatit 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të shkresës.

11. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

12. Më 2 qershor 2021, kompania "Dardafon" dorëzoi në Gjykatë përgjigjen e saj lidhur me kërkesën.

13. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese."

14. Më 14 korrik 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për komentet e dorëzuara nga kompania "Dardafon".

15. Më 16 korrik 2021, Gjykata kërkoi informata nga parashtruesi i kërkesës lidhur me pohimin e parashtruesit të kërkesës se Ministria e Ekonomisë ka treguar gatishmëri të ofrojë ndihmën e saj për zgjidhjen e çështjes që ndërlidhet me ekzekutimin e vendimit që është objekt kontesti para Gjykatës.

16. Më 27 korrik 2021, Gjykata pranoi përgjigjen e parashtruesit të kërkesës me të cilën njoftoi Gjykatës se *"deri më tani Telekomi nuk ka pranuar asnjë ndihmë konkrete materiale nga [Ministria e*

Ekonomisë] ME lidhur me ekzekutimin e Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit pranë ICC nr. 20990/MHM të datës 09 Dhjetor 2016."

17. Më 8 shtator 2021, Kolegji shqyrtues vendosi që kërkesa të shqyrtohet në një seancë të ardhshme.

18. Më 27 shtator 2021, Gjykata kërkoi nga Përmbaruesi privat, dorëzimin e dosjes së plotë të rastit.

19. Më 7 tetor 2021, Përmbaruesi privat dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës.

20. Më 24 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

21. Në të njëjtën ditë, Gjykata vendosi, njëzëri, që kërkesa është e pranueshme dhe: *i)* me shumicë votash, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; *ii)* me shumicë votash, shpalli të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.12/20, të 20 janarit 2021 dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 3610/20 të 8 tetorit 2020; *iii)* me shumicë votash, ktheu Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3610/20 të 8 tetorit 2020, për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate; si dhe *iv)* njëzëri, refuzoi kërkesën për masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

22. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës lidhur me këtë rast i është drejtuar Gjykatës edhe me kërkesën KI179/20, lidhur me të cilin Gjykata ka nxjerrë Aktvendimin për Papranueshmëri të 27 janarit 2021, Parashtrues *Telekomi i Kosovës SH.A.*(në tekstin e mëtejmë: rasti KI179/20). Në Rastin KI179/20, Gjykata vendosi njëzëri që kërkesa është e papranueshme në baza kushtetuese sepse është e parakohshme siç përcaktohet me nenin 113 paragrafi 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së Punës. Kjo pasi, Gjykata konstatoi se lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës, paralelisht me kërkesën që parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar para Gjykatës Kushtetuese, ishte duke u zhvilluar procedura gjyqësore para Gjykatës Supreme, e cila ende nuk kishte nxjerrë vendim lidhur me kërkesën për mbrojte të ligjshmërisë ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.3610/20] dhe Aktvendimin [PPP.nr.1486/19] të Gjykatës Themelore, të paraqitur nga e Zyra e Kryeprokurorit të

Shtetit. Rrjedhimisht, Gjykata gjithashtu, në pajtim me nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit dhe rregullin 57 paragrafi (1) të Rregullores së Punës, vendosi që kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet sepse nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit.

23. Në vijim Gjykata i referohet dhe fakteve të paraqitura si në rastin KI179/20, pasuar me procedurat e reja të zhvilluara pas nxjerrjes së Aktvendimit të Gjykatës lidhur me rastin KI179/20.

24. Gjykata rikujton se lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës janë zhvilluar tri procedura:

1) Procedura e arbitrazhit lidhur me zgjidhjen e kontestit nga Marrëveshja për Shërbimet Mbështetëse të Operatorit Virtual të Rrjetit Mobil, e nënshkruar në mes të parashtruesi i kërkesës dhe kompanisë "Dardafon";

2) Procedurat lidhur me njohjen e Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit në Kosovë pas kontestit nga Marrëveshja për Shërbimet Mbështetëse të Operatorit Virtual të Rrjetit Mobil; dhe

3) Procedura lidhur me përmbarimin e Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit lidhur me kontestin nga Marrëveshja për Shërbimet Mbështetëse të Operatorit Virtual të Rrjetit Mobil.

25. Parashtruesi i kërkesës, ashtu si edhe në rastin KI179/20, konteston para Gjykatës specifikisht procedurën e tretë, që ndërlidhet me procedurën për përmbarimit të Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit lidhur me kontestin nga Marrëveshja për Shërbimet Mbështetëse të Operatorit Virtual të Rrjetit Mobil. Megjithatë Gjykata në vijim do të paraqesë faktet lidhur me tri procedurat e lartcekura.

1) Procedurat e zhvilluara lidhur me kontestin nga Marrëveshja për Shërbimet Mbështetëse të Operatorit Virtual të Rrjetit Mobil

26. Më 16 janar 2009, parashtruesi i kërkesës dhe pala e interesuar - kompania "Dardafon" nënshkruan "Marrëveshjen për Shërbimet mbështetëse të Operatorit Virtual të Rrjetit Mobil" (në tekstin në vijim: MSA) në bazë të së cilës kompania "Dardafon" u pajtua që të ofrojë shërbime mobile tek parashtruesi i kërkesës nën një model të ndarjes së fitimit.

27. Më 13 prill 2015, pas mosmarrëveshjeve ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe kompanisë "Dardafon", lidhur me zbatimin e MSA-së, si dhe pas dështimit të tentativave për të zgjedhur mosmarrëveshjet

përmes pajtimit, kompania "Dardafon" e inicioi procedurën e arbitrazhit në Tribunalin e Arbitrazhit të Odës Ndërkombëtare të Tregtisë - ICC – International Chamber of Commerce (në tekstin e mëtejmë: Tribunali i Arbitrazhit).

28. Mundësia e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet arbitrazhit ishte e përcaktuar në MSA-në e nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës dhe kompania "Dardafon", e cila përcaktonte që: *"Çfarëdo kontesti nga palët në kuadër të kësaj Marrëveshje do të jetë subjekt i një procedure të brendshme të zgjidhjes së kontestit që duhet të dakordohet. Nëse çështja nuk mund të zgjidhet përmes asaj procedure, cilado palë mund të inicioje arbitrimin në Londër, Angli, sipas rregullave të Odës Ekonomike Ndërkombëtare ("OEN"). Nëse palët nuk mund të dakordohen për një arbitër të vetëm, atëherë secila palë do ta caktojë një arbitër dhe dy arbritrat do ta caktojnë arbitrin e tretë. Të gjitha vendimet arbitrare janë përfundimtare dhe nuk mund të sfidohen në gjyq. Pala e cila e inicion arbitrimin do t 'i bartë shpenzimet e një iniciative të tillë."*

29. Më 9 dhjetor 2016, Tribunali i Arbitrazhit nxori Vendimin Final [nr. 20990/MHM] përmes të cilit: (1) Tribunali i Arbitrazhit e urdhëron parashtruesin e kërkesës që menjëherë: (a) T'i alokohen kompanisë "Dardafon" numrat e kërkuar mobil në pajtim me Nenin 2.6.1 të Marrëveshjes për Mbështetje; b) T'i ofrohen kompanisë "Dardafon" shërbimet e kërkuara 3G dhe 4G në pajtim me Nenin 2.4.1 të Marrëveshjes për Mbështetje; (2) Tribunali i Arbitrazhit deklaron se në pajtim me Marrëveshjen për Mbështetje, kompanisë "Dardafon" duhet t'i liferohet ajo sasi e SIM kartelave siç ka kërkuar i njëjti kohë pas kohe; (3) Tribunali i Arbitrazhit e urdhëron parashtruesin e kërkesës që t'ia paguajë kompanisë "Dardafon" dënimin kontraktues në shumën totale prej 8,785.000 € plus kamatën prej 8% që nga data 14 prill 2015. Kjo shumë përfshinte dënimin kontraktues që është llogaritur deri në datën e marrjes së këtij Vendimi Përfundimtar si në vijim: (a) 1,315,000 € për vonesën e liferimit të SIM kartelave të kërkuara; (b) 3,800,000 € për mosdhënien e numrave mobil të kërkuar; (c) 3,670.000 € për mosdhënien e shërbimeve 3G dhe 4G të kërkuara; (4) Tribunali i Arbitrazhit e urdhëron parashtruesin e kërkesës t'ia paguajë kompanisë "Dardafon" dëmet në emër të humbjes së fitimeve në shumen totale prej 17,315,000 € plus kamatën prej 8% që nga data 14 prill 2015; (5) Tribunali i Arbitrazhit e urdhëron parashtruesin e kërkesës t'ia paguajë kompanisë "Dardafon" dënimin kontraktues prej 5,000 € për secilin rast të vonesës së mëtutjeshme që llogaritet në ditë që nga data e marrjes së këtij vendimi e deri në përmbushjen nga i Padituri të Urdhrave 1. a) dhe 1. b) të lartë shënuara, me kushtin dhe deri në atë shkallë sa shuma totale e këtyre

ndëshkimeve e tejkalon shumën prej 17,315,000€ në bazë të Urdhrit 4, më lart; 6) Refuzohen të gjitha kërkesat tjera për kompensim; 7) Obligohet parashtruesi i kërkesës t'ia paguajë kompanisë "Dardafon" shumën prej 75% të shpenzimeve që i ka pësuar në këtë procedurë arbitrazhi, me përjashtim të shpenzimeve që i ka bërë stafi i brendshëm i kompanisë "Dardafon", d.m.th. shumen prej 972,121.22 € dhe 534,000.00 USD.

2) Procedurat lidhur me njohjen e Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit

30. Më 7 mars 2017, kompania "Dardafon" parashtroi në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Ekonomike (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore) propozim për njohjen dhe ekzekutimin e Vendimit Final [nr. 20990/MHM] të 9 dhjetor 2016, të Tribunalit të Arbitrazhit.

31. Më 24 maj 2017, ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe kompanisë "Dardafon" u arrit një Marrëveshje për Ekzekutimin e Vendimit Final [nr. 20990/MHM] të të 9 dhjetor 2016, të Tribunalit të Arbitrazhit.

32. Më 2 qershor 2017, kompania "Dardafon" e tërhoqi propozimin për njohjen dhe ekzekutimin e Vendimit Final të Tribunalit të Arbitrazhit, bazuar në marrëveshjen e arritur. Rrjedhimisht, më 19 qershor 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [IV.C.118/17] konstatoi tërheqjen e propozimit për njohjen dhe ekzekutimin përfundimtar të Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit.

33. Më 27 prill 2018, kompania "Dardafon" përmes shkresës [01–1562/18] njoftoi parashtruesin e kërkesës për shkëputjen e Marrëveshje për Ekzekutimin e Vendimit Final të Tribunalit të Arbitrazhit, bazuar në moszbatimin adekuat të kësaj Marrëveshjeje që përcaktohej në nenin 8.3 të saj. Gjithashtu, kompania "Dardafon" thekson se bazuar në nenin 8.3 të kësaj Marrëveshjeje, në rast të shkëputjes së Marrëveshjes nga kompania "Dardafon", do të hyjnë në fuqi dispozitat e Vendimit Final [nr. 20990/MHM] të 9 dhjetor 2016, të Tribunalit të Arbitrazhit.

34. Më 16 korrik 2018, kompania "Dardafon" parashtroi Propozimin për njohjen dhe ekzekutim të Vendimit Final [20990/MHM] e 9 dhjetorit 2016, të Tribunalit të Arbitrazhit, në Gjykatën Themelore.

35. Më 11 shkurt 2019, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [IV.C.nr. 388/18] vendosi që të: (i) njihet dhe shpallet i ekzekutueshëm vendimi i Tribunalit të Arbitrazhit, pranë Odës Ekonomike Ndërkombëtare

(ICC), Rasti OEN-it, me nr.20990/MHM, Vendi i Arbitrazhit: Londër, Angli, Vendimi përfundimtar i datës 9 dhjetor 2016, në çështjen juridike në DARDAFON.NET L.L.C, [...], si paditës dhe Telekomi i Kosovës sh.a (ish PTK sh.a) [...] si i paditur, në tërësi, si në Dispozitivin e Vendimit të lartcekur; (ii) Obligohet parashtruesi i kërkesës që kompanisë "Dardafon" t'ia paguaj shpenzimet e procedurës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit në shumën prej 2.150.00 €.

36. Më 19 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, për shkak të (i) zbatimit të gabuar të ligjit material, me propozim që aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

37. Më 1 prill 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ae. nr. 88/2019] e hodhi poshtë si të palejuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, e parashtruar kundër Aktvendimit [IV.C.nr. 388/18] të 11 shkurtit 2019, të Gjykatës Themelore. Rrjedhimisht, ky Aktvendim u bë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm.

3) Procedura e zhvilluar lidhur me përmbarimin e Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit, të cilën procedurë parashtruesi e konteston para Gjykatës

38. Më 8 korrik 2019, kompania "Dardafon" parashtroi Propozimin për Përmbarim të Vendimit final [nr. 20990/MHM] të 9 dhjetor 2016, të Tribunalit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Paris.

39. Më 15 korrik 2019, Përmbaruesi privat lëshoi Urdhrin Përmbarimor [P.nr. 491/19] me të cilin lejoi Përmbarimin e propozuar nga kompania "Dardafon", në bazë të dokumentit përmbarues, përkatësisht Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit [nr. 20990/MHM] të 9 dhjetorit 2016, në vlerën prej *"25,000,000.00 EUR (për konfirmim nga ekspertiza financiare pas llogaritjes se kamatës)"*.

40. Më 18 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi Prapësim kundër Urdhrit Përmbarimor [P.nr. 491/19] me propozimin që: (i) të pranohet në tërësi si i bazuar Prapësimi i parashtruesit të kërkesës; (ii) të anulohet Urdhri përmbarimor [P.nr. 491/19] i 15 korrikut 2019, i Përmbaruesit privat; dhe (iii) të refuzohet si i pa bazuar Propozimi për përmbarim i kompanisë "Dardafon". Në prapësimin e tij, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se (i) dokumenti në bazë të cilit është lëshuar Urdhri Përmbarimor, nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare

të përmbarueshmërisë, sipas nenit 71.1.1 Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejmë: LPP-së); (ii) përmes dokumentit publik ose dokumentit të certifikuar në pajtim me ligjin palët janë pajtuar të mos kërkohet përmbarimi në bazë dokumentit përmbarues, sipas nenit 71.1.1.3 të LPP-së; dhe (iii). kërkoi nga Gjykata Themelore të mbahet seanca publike bazuar në nenin 73 të LPP-së.

41. Më 24 korrik 2019, kompania "Dardafon" parashtroi përgjigje në prapësimin e debitorit duke theksuar se pretendimet e debitorit të parashtruara në prapësim janë te pabazuara në ligj dhe se urdhri përmbarimor kundërshtohet në baza ligjore të pajustifikuara dhe me qëllim të prolongimit të procedurave të përmbarimore.

42. Më 22 qershor 2020, u mbajt seanca për shqyrtimin e validitetit të prapësimit të debitorit, në kuadër të Gjykatës Themelore me ç'rast kjo e fundit kishte nxjerrë Konkluzion me të cilin detyroi kompaninë "Dardafon" që në afat prej (tre) 3 ditësh të parashtroj në Gjykatën Themelore parashtresë për precizimin e propozimit për përmbarim dhe atë lidhur me shumën e përgjithshme të borxhit kryesor.

43. Më 25 qershor 2020, , kompania "Dardafon" parashtroi plotësimin e propozimit (plotësimi i propozimit ishte regjistruar në Gjykatën Themelore më 29 qershor 2020) ku precizohej saktësisht shuma e borxhit të përgjithshëm, duke kërkuar që të detyrohet parashtruesi i kërkesës që në emër të borxhit të paguaj shumën e përgjithshme prej 24,684,003.15 €, me kamatë 8% në vit e cila do të llogaritej nga 8 korriku 2019 e deri në pagesën definitive. Kompania "Dardafon" gjithashtu dorëzoi një Raport të Auditorit Ligjor, lidhur me kalkulimin e shumës së lartcekur dhe prova lidhur me pagesat e kryera ndaj parashtruesit të kërkesës. Në raportin e lartcekur të auditorit përcaktohej që *"Shuma e përgjithshme e detyrimit të mbetur është objekt i verifikimit dhe konstatimit përmes ekspertizës së caktuar nga përmbaruesi privat gjatë llogaritjes së kamatave të urdhëruara nga Vendimi Përfundimtar i Arbitrazhit"*.

44. Më 6 korrik 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP.nr.1486/19]: (i) aprovoi si pjesërisht të bazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës, lidhur me shumën 315,996.85€, ashtu që shfuqizoi Urdhrin për Caktimin e Përmbarimit [P.nr.491/2019] të 15 korrikut 2019, në lidhje me këtë shumë të lëshuar nga Përmbaruesi privat; dhe (ii) refuzoi si të pabazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me shumën 24,684,003.15 €, dhe për këtë pjesë vendosi që Urdhri për Caktimin e Përmbarimit [P.nr.491/2019] i 15 korrikut 2019, i lëshuar nga Përmbaruesi privat, mbetet në fuqi.

45. Më 7 korrik 2020, parashtruesi i kërkesë kishte dorëzuar Deklarimin në Plotësimin e Propozimit për Përmbarim të kompanisë "Dardafon", të cekur më lart, duke kërkuar, mes tjerash, që të pranohet si i bazuar Prapësimi i parashtruesit të kërkesës ndërsa propozimi për përmbarim të konsiderohet i tërhequr. Parashtruesi i kërkesës, theksoi se e kundërshton Parashtresën e Kreditorit [kompanisë "Dardafon"], si nga aspekti formal dhe ai material. Nga aspekti formal, parashtruesi i kërkesës konsideroi se parashtresa e dorëzuar më 29 qershor 2020 nga ana e kreditorit është parashtruar me vonesë prej 4 ditësh, andaj kërkoi që propozimi për përmbarim, të konsiderohet i tërhequr. Sa i përket kundërshtimit në aspektin material, parashtruesi i kërkesës konsideroi se Konkluzioni i Gjykatës Themelore i 22 qershorit 2020, nuk gjen bazueshmëri në dispozitat e LPP dhe paraqet tejkalim të autorizimeve duke ia dhënë mundësinë Kreditorit që ta devijon vlerën e përmbarimit për të cilën veç e kishte marrë Urdhrin përmbarimor. Parashtruesi i kërkesës lidhur me vlerën e re 24,684,003.15 €, të njëjtën e kontestoi me arsyetimin që (i) nuk figuron në Vendimin final të Tribunalit të Arbitrazhit të OEN 20990/MHM të 9 dhjetorit 2016; (ii) Nuk figuron në Propozimin për Përmbarim të Kreditorit të 15 korrikut 2019; (iii) për këtë vlerë nuk është lëshuar urdhri përmbarimor P.nr. 491/19 i 15 korrikut 2019; dhe (iv) për këtë vlerë nuk është ushtruar prapësimi i debitorit.

46. Më 9 korrik 2020, kompania "Dardafon" përmes shkresës kërkon nga parashtruesi i kërkesës që ta përmbushë borxhin në mënyrë vullnetare deri më 10 korrik 2020.

47. Më 9 dhe 10 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës, përmes parashtresave kërkon nga organi përmbarimor shtyrjen e përmbarimit deri në vendosjen e çështjes nga Gjykata e Apelit, kërkesë kjo e cila u refuzua nga kompania "Dardafon", të cilët kërkuan nga organi përmbarues të veproj në përputhje me Aktvendimin [PPP.nr. 1486/19] të Gjykatës Themelore, pasi që nuk janë plotësuar kushtet ligjore për një kërkesë të tillë dhe se debitori nuk ka deponuar asnjë provë ose garanci.

48. Më 10 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit [PPP.nr. 1486/19] të 6 korrikut 2020, të Gjykatës Themelore në pjesën refuzuese të Përmbarimit, respektivisht kundër pikës (ii) të tij, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa e debitorit të aprovohet si e themeltë dhe të anulohet Aktvendimi i lartcekur, i Gjykatës

Themelore. Parashtruesi kërkesës pretendoi para Gjykatës së Apelit se Gjykata Themelore, mes tjerash, nuk kishe marrë për bazë parashtresën e parashtruesit të kërkesës pasi, sipas tij, Aktvendimi [PPP.nr.1486/19] i Gjykatës Themelore ishte i gatshëm një ditë përpara, pra më 6 korrik 2020, pa shqyrtuar qëndrimin e parashtruesit të kërkesës rreth Precizimit të Propozimit për Përmbarim të kompanisë "Dardafon" dhe dokumentet tjera përcjellëse, dhe duke shkelur kështu dispozitat ligjore dhe duke mohuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për tu deklaruar me shkrim dhe përmes seancës dëgjimore rreth pretendimeve të kompanisë "Dardafon", konform nenit 182.2 (i) të Ligjit nr. 03/l-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK) aq më tepër kur bëhet fjalë për pretendime dhe dokumente të reja.

49. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ngriti çështjen e pranueshmërisë së Precizimit të Propozimit për Përmbarim pasi konsideroi se parashtresa e dorëzuar më 29 qershor 2020 nga ana e kreditorit është parashtruar me vonesë prej 4 ditësh, andaj kërkoi që propozimi për përmbarim, të konsiderohet i tërhequr.

50. Në një datë të pasaktësuar, kompania "Dardafon" kishte parashtruar përgjigje në ankesë, duke kundërshtuar pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, me propozimin që Gjykata e Apelit këtë ankesë ta konsiderojë të palejueshme, ose të njëjtën ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

51. Më 14 korrik 2020, Përmbaruesi privat, përmes Konkluzionit [P.nr. 491/19] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës, për shtyrje të përmbarimit.

52. Më 15 korrik 2020, Përmbaruesi privat përmes Urdhrit [P.nr.491/19] urdhëroi Bankat Komerciale në Kosovë: PCB, RBKO, BKT, NLB, BPB, TEB, Banka Ekonomike, Is Bank, Ziraat Bank, që brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve pas pranimit të këtij urdhri, t'i japë përmbaruesit privat të dhënat se (i) a ka parashtruesi i kërkesës llogari në këto banka; dhe (ii) nëse i njëjti ka mjete ne llogari bankare të bllokohen mjetet në emër të borxhit kryesor, kamatës ligjore, shpenzimeve kontestimore dhe shpenzimeve përmbarimore në shumën totale prej 26,789,532.62 Euro.

53. Më 20 korrik 2020, personi i tretë – përkatësisht Aksionari i parashtruesit të kërkesës (Qeveria e Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike) ka dorëzuar kërkesën për pezullimin e veprimeve të

ndërmarra nga ana e organit të përmbarimit si dhe shtyrjen e procedurës përmbarimore.

54. Më 20 korrik 2020, pas kërkesës së përmbaruesit drejtuar kompanisë "Dardafon" për t'u deklaruar lidhur me kërkesën e personit të tretë, përkatësisht Qeverisë së Kosovës, i njëjti e kundërshton këtë kërkesë për shtyrje të përmbarimit pasi që e njëjta nuk ka mbështetje ligjore, dhe se kërkon nga organi i përmbarimit që të njëjtën ta refuzojë si të pabazuar.

55. Më 21 korrik 2020, Përmbaruesi privat, përmes Konkluzionit [P.nr. 491/19] refuzoi si të pabazuar kërkesën e personit të tretë, Aksionarit Qeveria e Kosovës-Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike për shtyrjen e procedurës së përmbarimit.

56. Më 21 korrik 2020, Përmbaruesi privat, përmes Urdhrit për Transfer [P.nr. 491/19] detyroi Raiffeisen Bank, që nga parashtruesi i kërkesës, brenda afatit prej (60) minutave pas pranimit të këtij urdhri, të bëjë ekzekutimin e borxhit kryesor, kamatës ligjore, shpenzimet e procedurës përmbarimore, shpenzimet e procedurës kontestimore si dhe zbatimin e efikasitetit të Zyrës Përmbarimore, në vlerat si me poshtë: Gjithsej: 26,789,532.62 Euro.

57. Më 29 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës dhe kompania "Dardafon", në praninë e aksionarit të parashtruesit të kërkesës në cilësinë e garantuesit, arrijnë një marrëveshje për lirimin e përkohshëm të llogarive rrjedhëse bankare.

58. Në po të njëjtën datë, Përmbaruesi privat përmes urdhrit [P.nr.491/19] detyroi bankat komerciale në Kosovë që të debllokojnë llogarinë bankare të parashtruesit të kërkesës, si rezultat i krijimit të rrethanave të reja, përkatësisht arritjes së marrëveshjes ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe kompanisë "Dardafon".

59. Më 8 tetor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 3610/20] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktvendimin [PPP.nr. 1486/19] e 6 korrikut 2020, të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit, konsideroi se Gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim të drejtë në bazë të provave që gjenden në shkresat e lendes. Gjykata e Apelit u bazua në nenin 21 të LPP-së e 22 të LPP-së, të cilat përcaktojnë dokumentet përmbaruese dhe bazuar në këtë Gjykata e Apelit konsideroi se përmbarimi është lejuar në bazë të Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit, OEN nr. 20990/MHM të 9 dhjetorit 2016, i njohur me Aktvendimin e Gjykatës Themelore IV.C.nr

388/18 të 11 shkurtit 2018, i cili dokument i plotëson kushtet sipas dispozitave të LPP-së. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se vendimi final i arbitrazhit nuk posedon klauzolën e përmbarimit, Gjykata e Apelit theksoi se sipas LPP-së, si dokumente përmbarimore parashihen edhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujditë brenda këtyre gjykatave, të cilat janë pranuar për përmbarim në territorin e Kosovës.

60. Lidhur me pretendimin për Marrëveshjen e ekzekutimit të vendimit përfundimtar të Arbitrazhit, e nënshkruar mes kompanisë "Dardafon" dhe parashtruesit të kërkesës me 14 maj 2017, e cila ka statusin e dokumentit përmbarimor sepse paraqet Akt Noterial, i cili nuk mund të shkëputet nga kreditori, Gjykata e Apelit sqaroi se me këtë akt noterial, është bërë vërtetimi i Marrëveshjes se ekzekutimit të vendimit përfundimtar të Arbitrazhit dhe marrë parasysh që parashtruesit i kërkesës nuk ishte në gjendje të paguajë dhe përmbushë detyrimet që rrjedhin nga vendimi i Arbitrazhit e që në bazë nenit 8.3 të Marrëveshjes parashtruesi i kërkesës është pajtuar që në rast dështimi të përmbushjes së obligimeve nga pika 1.6 e Marrëveshjes, kompania "Dardafon", mund të shkëpus këtë marrëveshje dhe automatikisht hyjnë në fuqi dispozitat e vendimit final të Arbitrazhit.

61. Kurse sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se me precizimin e kërkuar nga ana e kreditorit, është krijuar vlerë e re e përmbarimit, e që vlerën e tillë nuk e përmban as vendimi i Arbitrazhit 20990/MHM, Gjykata theksoi se në këtë vendim, përkatësisht në pikën 3, është caktuar vlera prej 8,785.000 euro, plus kamata prej 8% që nga data 14 prill 2015, më pas në pikën 4, është caktuar vlera prej 17, 315.000 euro, plus kamata prej 8 % që nga 14 prilli 2015. Gjithashtu në pikën 5 është përcaktuar dënimi kontraktues prej 5000 Euro, për secilin rast të vonesës nga pika 1, a) dhe b), ndërsa në pikën 7, vlera prej 972,121. 22 euro si dhe vlera prej 534,000.00 USD. Lidhur me këto vlera, Gjykata e Apelit theksoi se precizimi i borxhit është bërë në përputhje me vendimin e Arbitrazhit, si dhe pagesave të bëra të parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht Gjykata e Apelit theksoi se *"sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shumën e borxhit, përmbaruesi privat duhet që gjatë zhvillimit të procedurës përmbarimore, të bëjë llogaritjen e kamatave si dhe dënimit kontraktues të përcaktuara në dokumentin përmbarues, deri në përmbushjen në tërësi të detyrimit duke u bazuar në dispozitën e nenit 43, paragrafi 3 të LPP-së"[...].* Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk përmbante arsyetim specifik lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Themelore kishte mohuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për tu deklaruar rreth

pretendimeve të kompanisë "Dardafon", lidhur me Precizimin e borxhit..

62. Më 3 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit me propozim për inicimin e kërkesës për mbrojte të ligjshmërisë në Gjykatë Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore [PPP.nr.1486/19] dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 3610/20]. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij theksoi se lidhur me parashtresën e dorëzuar nga kreditori, dhe vendimin e nxjerrë më 6 korrik 2020, nga Gjykata Themelore përmes Aktvendimit PPP.nr.1486/19, atij iu është mohuar e drejta që të deklarohet rreth kësaj parashtrese dhe vlerës së re të përmbarimit që dallonte nga kërkesa fillestare e tij. Lidhur me këtë të fundit, parashtruesi theksoi se vlera e re e kërkesës, nuk ishte objekt i propozimit për përmbarim dhe lidhur me këtë nuk është lëshuar urdhër përmbarimor nga përmbaruesi privat. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu konsideroi se ekspertiza e 22 qershorit 2020 e përgatitur nga auditori si dhe numri i konsiderueshëm i fatura dhe debit notave, nuk ishin dorëzuar më herët dhe në këto prova, parashtruesit të kërkesës nuk i ishte mundësuar që të deklarohet. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Themelore do duhej të caktonte shqyrtim të ri, përmes të cili parashtruesi i kërkesës do kishte mundësinë e deklarimit lidhur vlerën e propozimit. Andaj parashtruesi i kërkesës konsideroi se dy gjykatat e instancave më të ulta kanë shkelur të drejtat e tij ligjore dhe kushtetuese, sepse nuk i kanë dhënë parashtruesit mundësinë e shqyrtimit të çështjes, pasi ende pa pranuar qëndrimin e parashtruesit të kërkesës, lidhur me precizimin e urdhërit për përmbarim, ishte nxjerrë vendimi i Gjykatës Themelore.

63. Më 10 nëntor 2020, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kishte paraqitur kërkesën për mbrojte të ligjshmërisë [KMLC.nr.152/2020] në Gjykatë Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore [PPP.nr.1486/19] dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 3610/20]. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, u bazua në nenin 247, paragrafi 1 pika a) të LPK-së, duke theksuar se parashtruesi kërkesës në kërkesën për mbrojte të ligjshmërisë, nuk ka pasur mundësinë që me shkrim ose në seancë dëgjimore të deklarohet rreth propozimit të precizuar për përmbarim, dhe duke u bazuar në nenin 5 pika 5.1 të LPK-së, gjykata është dashur të mundësojë që parashtruesi i kërkesës të deklarohet mbi pretendimet e paraqitur në parashtresën e kompanisë "Dardafon".

64. Më 18 dhjetor 2020, në zyrën e Përmbaruesit Privat I.M. ishte mbajtur seanca dëgjimore e thirrur nga parashtruesi i kërkesës dhe kompania "Dardafon", lidhur me borxhin në shumë 17.281.141, 98 euro, me

ç'rast ashtu si reflektohet në Procesverbalin e kësaj seance dëgjimore, nënshkruar nga përfaqësuesit e kompanisë "Dardafon" dhe parashtruesit e kërkesës, ishte nxjerr Konkluzioni në vijim dhe:

> *1. Aprovohet marrëveshja e arritur ndërmjet palëve për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të specifikuara si më lartë dhe kjo marrëveshje do të hyje në fuqi pas nënshkrimit të saj.*
> *2. Obligohet debitori t'i paguaj këstet mujore te borxhit në shume prej 749.973,60€ sipas plan it të amortizimit të pagesave të specifikuara si më lartë (nga data 15 janar 2021).*
> *3. Obligohet debitori t'i paguaj këstet mujore të shpenzimeve në shumën prej 10,619.62€ për çdo muaj sipas pagesave të specifikua si më lartë (nga data 15 janar 2021).*
> *4. Ne rast të dështimit të marrëveshjes nga debitori në përmbushjen e detyrimeve të kësteve të borxhit dhe shpenzimeve sipas dinamikës së pagesave do të veprohet komform kërkesës së kreditorit për përmbushjen e tërësishme të borxhit, kamatëvonesës dhe shpenzimeve.*

Nga një kopje e kësaj marrëveshje ju dorëzohet të dy palëve"

65. Më 20 janar 2021 Gjykata Supreme mbajti shqyrtimin në të cilin ishin prezent parashtruesi i kërkesës dhe kompania "Dardafon". Në këtë seancë kreditori [kompania "Dardafon"], konsideroi se sa i përket pretendimit se debitorit [parashtruesi të kërkesës], nuk iu është dhënë mundësia e deklarimit, nuk qëndron. Sipas kreditorit, ai nuk ka bërë llogaritjen e kamatave në kërkesën e tij për përmbarim. Kreditori deklaroi se me 25 qershor 2020 i ka kalkuluar edhe kamatën bashkë me vërtetimin e një revizori. Kreditori rrjedhimisht konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk ka kundërshtuar parashtresën përkatëse. Kreditori në seancë gjithashtu kishte konsideruar se debitori dhe prokurori asnjëherë nuk kishin konsideruar se kamatat janë llogaritur gabim dhe për këtë konsideron se nuk ka pasur nevojë për seancë të veçantë. Parashtruesi i kërkesës, në anën tjetër u deklarua në këtë seancë, me ç'rast i përsëriti pretendimet e tij si në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, duke theksuar se nuk iu është dhënë mundësia e deklarimit lidhur me parashtesën e kreditorit, pasi ajo kishte pranuar parashtresat më 6 korrik 2020 ndërsa përgjigjen e lidhur me ato parashtresa e kishte dorëzuar më 7 korrik 2020, megjithatë, Gjykata Themelore vendimin e saj lidhur me rastin e kishte nxjerr më 6 korrik 2020, pa pritur përgjigjen e parashtruesit të kërkesës, dhe për më tepër pa mbajtur seancë dëgjimore. Andaj,

Parashtruesi i kërkesës theksoi se gjykatat e rregullta kanë shkelur parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve.

66. Më 20 janar 2021, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit CML.nr.12/20, refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit. Gjykata Supreme theksoi se sa i përket çështjes së ngritur nga Prokurori i Shtetit, parashtruesit të kërkesës nuk iu është dhënë mundësia për sqarim lidhur me pretendimet e paraqitura më 29 qershor 2020, dhe në ekspertizën e bashkangjitur të F.P. Gjykata Supreme fillimisht u referua në nenin 247 paragrafi 1, të LPK-së përmes të cilës përcaktohet kushtet për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe pretendimin për mbajtjen e seancës e konsideroi si të pathemeltë. Më tej Gjykata Supreme arsyetoi se në procedurën përmbarimore kur vendoset për prapësimin si mjet i goditjes, gjykata ka në diskrecion të vlerësojë nevojën e mbajtjes së seancës dëgjimore. Gjykata Supreme theksoi se neni 247 paragrafi 1 i LPK-së i referohet çështjes kur gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore.

67. Gjykata Supreme duke theksuar se pretendimin e parashtruesit të kërkesës e vlerëson në frymën e dispozitës së nenit 247 paragrafi 1 të LPK-së dhe duke marrë për bazë specifikat e procedurës së përmbarimit theksoi se gjykatat e shkallëve më të ulta nuk kanë cenuar të drejtat e parashtruesit të kërkesës. Në rastin konkret Gjykata Supreme, theksoi se nxjerrja e aktgjykimit pa seancë të shqyrtimit kryesor si shkelje i referohet rasteve kur është e nevojshme marrja e provave për konstatimin e fakteve thelbësore dhe në këtë mënyrë është mohuar një mundësi e tillë për palët, ndërsa në procedurën e përmbarimit shkaqet e prapësimit kryesisht vlerësohen pa mbajtjen e seancës dëgjimore. Megjithatë në këtë rast, Gjykata Supreme konsideroi se Gjykata Themelore në prapësim pas mbajtjes së një seancë dëgjimore ka konsumuar çdo shkelje të mundshme lidhur me pretendimet e mbajtjes së seancës. Tutje, Gjykata Supreme theksoi se mbajtja e seancës është një mundësi ligjore që e konsideron gjykata në rastet kur pranon në shqyrtim dhe vendosje prapësimin e palës nëse natyra e kundërshtimeve është e tillë që nënkupton qartësimin e disa pretendimeve që ndodh pas dëgjimit të palëve. Andaj Gjykata Supreme, konsideroi se nuk nënkupton që gjykata në procedurën e përmbarimit do caktoj disa seanca dëgjimore dhe në këtë mënyrë të marrë në vlerësim edhe çështje që janë konsumuar në procedurën e nxjerrjes së dokumentit përmbarimor.

68. Gjykata Supreme konsideroi se natyra e pretendimeve të parashtruara nga prokurori i shtetit janë të tilla që do të mund të parashtroheshin nga debitori [parashtruesi i kërkesës], në procedurën e evitimit të

parregullsive nga ana e përmbaruesit, dhe sipas Gjykatës Supreme, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar me të drejtë pretendimet që i janë referuar lejueshmërisë së përmbarimit, duke përfshirë përshtatshmërinë e dokumentit përmbarimit dhe të gjitha pretendimeve tjera siç përcaktohet me LPP.

69. Më tej, Gjykata Supreme arsyetoi se pretendim i Prokurorit të Shtetit, për dhënien e mundësisë të deklarimit lidhur me parashtresën e kreditorit dhe ekspertizën e F.P, janë të pathemelta dhe pa ndikim në vendosje ndryshe sepse *"as me parashtresë dhe as me ekspertizën e pretenduar nuk është ndryshuar përmbajtja e kredisë/kërkesës së caktuar në dokumentin përmbarimor, i cili paraprakisht ka kaluar procedurën e njohjes. Pra, nëse debitori ka vlerësuar se me ekspertizën e referuar është bërë ndonjë parregullsi në procedurën e zbatimit të përmbarimit, ka pasur mundësi të kërkoj në procedurë të veçantë nga gjykata evitimin e parregullsive, përndryshe edhe në rastin e dëgjimit të thirrur nga Gjykata Supreme me 20.01.2021, nuk është paraqitur ndonjë pretendim substancial me shpjegime se si ka ndikuar parashtresa dhe ekspertiza në ndryshimin e kredisë së caktuar me dokumentin përmbarues.*

Marrja e një ekspertize në procedurën e përmbarimit është e zakonshme sidomos kur është e nevojshme llogaritja e ndonjë kërkese të gjykuar në mënyrë periodike, apo edhe kamatave e kërkesave tjera të njëpasnjëshme, por standardi në praktikë nënkupton se një ekspertizë e tillë nuk mund të merret në fazën para se të lejohet përmbarimi, por mund të merret pasi të përfundohet faza e lejimit të përmbarimit. Fakti se Kreditori ka paraqitur një ekspertizë, nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e procedurës sepse organi përmbarimor pasi që urdhri përmbarimor është bërë i formës së prerë, ka bërë marrjen e provës për përllogaritjen e kërkesave dhe në këtë mënyrë ndikimi i ekspertizës së paraqitur nga kreditori nuk ka asnjë ndikim."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

70. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës Supreme atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

71. Parashtruesi i kërkesës ri-thekson se me 22 qershor 2020, në shqyrtimin e mbajtur lidhur me validitetin e Prapësimit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore kishte nxjerrë

'Konkluzionin' me të cilin e kishte detyruar kompaninë "Dardafon" që brenda afatit prej 3 (tre) ditësh ta dorëzojë parashtresën për precizimin e propozimit për përmbarim.

72. Sipas parashtruesit të kërkesës, këtë parashtresë kompania "Dardafon" e kishte dorëzuar më 29 qershor 2020, dhe të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar më 6 korrik 2020. Sipas parashtruesit, më 7 korrik 2020,i njëjti parashtroi "Deklarimin rreth Parashtresës së Kreditorit (kompanisë "Dardafon")".

73. Rrjedhimisht, sipas pretendimit ende pa u deklaruar parashtruesi i kërkesës, apo sipas tij, në të njëjtën kohë kur parashtruesi i kërkesës kishte pranuar Precizimin e Propozimit për Përmbarim të kompanisë "Dardafon" me 6 Korrik 2020, Gjykata Themelore veç e kishte përgatitur dhe nxjerrë Aktvendimin [PPP.nr. 1486/19], duke ia mohuar të drejtën ligjore që të deklarohet rreth Parashtresës së kompanisë "Dardafon" për Precizimin e Propozimit për Përmbarim dhe vlerës së re të përmbarimit e cila dallonte nga vlera fillestare, që do të thotë se bëhej fjalë për Kërkesë të re.

74. Sipas parashtruesit të kërkesës, vlera e re e propozimit të kompanisë "Dardafon" sipas Parashtresës së 6 korrikut 2020, (i) nuk ishte as objekt i Propozimit fillestar të tij për Përmbarim; (ii) lidhur me këtë vlerë nuk ishte lëshuar Urdhri përmbarimor nga Përmbaruesi privat; dhe (iii) lidhur me këtë vlerë nuk ishte bërë Prapësimi i Debitorit dhe as nuk ishte caktuar shqyrtimi i 22 qershorit 2020.

75. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson se përpos Propozimit të ri dhe vlerës së re të përmbarimit, Parashtresa e kompanisë "Dardafon" përmbante edhe një "Ekspertizë financiare" të 22 qershorit 2020, e përgatitur nga ana e Auditorit F.P si dhe një numër të konsiderueshëm të faturave dhe debit notave të cilat asnjëherë nuk ishin të dorëzuara në ndonjë fazë të mëhershme të procedurës dhe se parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk ishte njoftuar me to.

76. Lidhur me këtë pikë parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 5 paragrafi 1, nenit 7 paragrafi 3 dhe nenin 357 paragrafi 2 të LPK-së, të cilat sipas tij zbatohen në procedurën përmbarimore dhe nënvizon si në vijim *"Gjykata Themelore e Prishtinës ka vendosur që lidhur me prapësimin e debitorit të mbante shqyrtim gjyqësor, në momentin kur kreditori, ende pa përfunduar shqyrtimi gjyqësor, ka ndryshuar Propozimin, vlerën e Propozimit dhe në momentin kur ka parashtruar prova të reja të cilat nuk i kishte parashtruar deri atëherë dhe as që i kishte parë ndonjëherë Debitori, Gjykata ka qenë e obliguar ta cakton shqyrtimin e ri me qëllim që Debitorit ti jepet*

mundësia të deklarohet rreth këtyre çështjeve dhe rrethanave të ndryshuara."

77. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit të kërkesës, këto shkelje ligjore ishin edhe ndër pretendimet kryesore të tij në ankesën e dorëzuar pranë Gjykatës së Apelit me 10 korrik 2020, dhe Propozimin për Mbrojtjen e Ligjshmërisë dhe Seancën Dëgjimore pranë Kolegjit të Gjykatës Supreme të 20 janarit 2021. Sipas parashtruesit të kërkesës, as Gjykata e Apelit e as Gjykata Supreme nuk e kanë elaboruar këtë pretendim ankimor.

78. Sipas parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta krijuan precedent përmes të cilit vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë pa iu mundësuar palës në procedurë të deklarohet lidhur me pretendimet e palës tjetër. Për pasojë, parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur dispozitat e procedurës dhe nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 KEDNJ-së, përkatësisht *"elementet thelbësore të nocionit "gjykim i drejtë" [...] a) parimi i kontradiktoritetit; b) parimi i "barazisë së armëve"; dhe c) e drejta në vendim të arsyetuar"*.

79. Sipas parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë përgjegjësinë që secilës palë (i) të iu jepet mundësia të jetë prezentë dhe dëgjohet; dhe (ii) t'iu ipet mundësia të prezantojë çështjen e tyre në kushte të tilla që mos të vihen në disavantazh ndaj palës tjetër. Lidhur me këtë pikë, parashtruesi i kërkesës referohet në rastet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin mëtejmë: GJENDJ), (i) *Keçmar dhe të tjerët kundër Republikës së Çekisë*, Aktgjykim i 3 marsit 2000; (ii) *Condron dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Aktgjykim i 2 majit 2000; dhe (iii) *Van Orshoven kundër Belgjikës,* Aktgjykim i 25 qershorit 1997.

80. Prandaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të nxjerr Aktgjykim përmes të cilit: (i) Kërkesa deklarohet e pranueshme; (ii) të konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iii) Ta shpallë si të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [CML.nr.12/20] të 20 janarit 2021 dhe të njëjtin ta kthejë në ri-shqyrtim; (iv) Të urdhërojë Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën Kushtetuese për masat e ndërmarra në lidhje me zbatimin e këtij Aktgjykimi; dhe (v) Të deklaroi se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Kërkesa për masën e përkohshme

81. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata edhe vendosjen e masës së përkohshme për shtyrjen e procesit të përmbarimit pasi që sipas tij zbatimi i përmbarimit do të shkaktonte (i) dëm të pariparueshëm për parashtruesin e kërkesës; dhe (i) do ti cenonte interesat shtetërore dhe nacionale nisur nga natyra e veprimtarisë së Telekom-it i cili, në rast të zbatimit të përmbarimit do të falimentonte për shkak të vlerës jashtëzakonisht të madhe të detyrimit.

82. Parashtruesi thekson se për shkak të bllokimit të llogarive bankare, ku rrezikohej falimentimi, parashtruesi i kërkesës u detyrua që të nënshkruajë *"Marrëveshjen për ekzekutimit e borxhit në procedurën përmbarimore"* me kompaninë "Dardafon", dhe sipas parashtruesit e vetmja arsye e nënshkrimit të kësaj marrëveshje është de-bllokimi i llogarive bankare për t'iu shmangur falimentimit.

83. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson që me vazhdimin e procedurës së përmbarimit, ekziston rreziku real që veprimtaria e Telekom-it të shuhet, duke prodhuar pasoja të papara negative në mirëvajtjen dhe funksionalizimin e të gjithë abonentëve të saj, e posaçërisht në funksionalizimin dhe veprimtarinë e organeve shtetërore dhe atyre të sigurisë në formën e pamundësimit të komunikimit në kryerjen e detyrimeve të tyre, si njëri prej segmenteve kryesore të veprimtarisë së tyre.

84. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës thekson që duke u nisur nga premisa e rrezikimit të interesit publik, rrezikimit të shkaktimit të dëmeve të pariparueshme dhe faktit se aksionari i saj - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka treguar gatishmëri që të ofrojë ndihmën e saj për zgjidhjen e kësaj çështjeje, me qëllim të parandalimit të këtyre rreziqeve, parashtron edhe kërkesë për caktimin e masës së përkohshme konform nenit 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Ndërsa përmes shkresës së 27 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës sqaroi se *"deri më tani Telekomi nuk ka pranuar asnjë ndihmë konkrete materiale nga [Ministria e Ekonomisë] ME lidhur me ekzekutimin e Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit pranë ICC nr. 20990/MHM të datës 09 Dhjetor 2016."*

85. Përfundimisht lidhur me vendosjen e masës së përkohshme, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të marrë Vendim për caktimin e masës së përkohshme, përmes të cilit: (i) miratohet masa e përkohshme në kohëzgjatje deri në marrjen e Vendimit meritor për rastin; (ii) Pezullohet menjëherë zbatimi i përmbarimit ndaj parashtruesit të kërkesës sipas Urdhrit Përmbarimor [P.nr. 491/19] të

15 korrikut 2019, të Përmbaruesit privat Ilir Mulhaxha, dhe Aktvendimit [PPP.nr. 1486/19] të 6 korrikut 2020, të Gjykatës Themelore; Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3610/20 të 8 tetorit 2020; e Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.12/20 të 20 janarit 2021 si dhe Marrëveshjes për ekzekutimin e borgjit në procedurën përmbarimore nr.01-156/09 të 17 nëntorit 2020 e lidhur mes kompanisë "Dardafon" dhe parashtruesit të kërkesës. (iii) Urdhërohet Përmbaruesi privat që ta njoftojë Gjykatën Kushtetuese për masat e ndërmarra lidhur me zbatimin e këtij Vendimi; (iv) Ky Vendim t'iu kumtohet palëve, parashtruesit të kërkesës dhe kompanisë "Dardafon".

Komentet e kompanisë "Dardafon"

86. Kompania "Dardafon", në përgjigjen e saj lidhur me kërkesën deklaron se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme sepse:
- kërkesa e parashtruesit nuk përmban emër të personit qe e ka nënshkruar, pra nuk është e qartë se kish e ka dorëzuar kërkesën ne Gjykatë, andaj kërkesa nuk është parashtruar nga personi i autorizuar;
- Parashtruesi i kërkesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimin e tij se Gjykata Supreme i'a ka cenuar të drejtat kushtetuese;
- vendimi i Gjykatës Supreme është i arsyetuar dhe se Gjykata Kushtetuese nuk është instance *"revizioniste dhe nuk shqyrton, nëse një gjykatë ka vendose drejtë apo jo një çështje"*. Parashtruesi i kërkesës i ka gëzuar të gjitha të drejtat pranë Gjykatës Supreme;
- Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetence lëndore të shqyrtoj nëse Gjykata e Shkalles së Parë në Procedurën Përmbarimore duhet të organizoj seancë shtesë për të vendosur lidhur me kërkesën e një kreditori për të ulur kërkesën kreditore;
- në rastin e parashtruesit nuk janë shterur mjetet juridike pasi parashtruesi ankohet lidhur me lartësinë e shumës së përmbarimit por për të kërkuar ndryshimin e pagesës që është bërë në mënyrë të gabuar parashtruesi i kërkesës është dashtë të bëjë padi për pasurim pabazë, gjë që parashtruesi i kërkesës nuk e ka bërë;
- është e paqartë se çka dëshiron të arrijë parashtruesi i kërkesës përmes kësaj procedure pasi lidhur me borxhin është nënshkruar marrëveshje për ekzekutimin e aktvendimit të Gjykatës Themelore, me 18 dhjetor 2020, andaj, tregohet qartë për intencën e keqpërdorimit të mjeteve juridike;
- kërkesa është e pabazuar po ashtu pasi Aktvendimi i Gjykatës Supreme nuk i shkel ne asnjë mënyrë të drejtat themelore kushtetuese të tij pasi ai vetëm konsideron se Gjykata Supreme ka

bërë shkelje ligjore dhe se Gjykata Themelore nuk ka pasur obligim të organizoj seancë dëgjimore;
- parashtruesi i kërkesës me asnjë provë nuk e ka dëshmuar se llogaritja e shumës së përmbarimit është bërë në mënyrë të gabuar;
- arsyet në të cilat thirret parashtruesi për nxjerrjen e masës së përkohshme nuk janë të ligjshme pasi vendimi për përmbarim është i bazuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2.Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

4. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE I PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR ME LIGJIN Nr. 05/L-118 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 3
Organi përmbarues dhe vendimet

[...]
5. Konkluzioni nxirret për zbatimin e disa veprimeve dhe për drejtimin e procedurës.

6. Kundër konkluzionit nga paragrafi 5. i nenit 3 të ligjit nuk është i lejuar mjeti juridik.

Neni 17
Zbatimi i dispozitave të ligjeve tjera

Në procedurën përmbarimore përshtatshmërish zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër.

Neni 43
Aktvendimi për përmbarim dhe urdhri për përmbarim

[...]
3. Në qoftë se me anë të aktvendimit për përmbarim apo urdhrit për përmbarim është caktuar pagimi i kamatave, atëherë llogaritjen e tyre, me shpenzime të kreditorit të përmbarimit, e bënë organi përmbarues, përpos kur realizimi i kamatave duhet të bëhet nga paratë e depozituara në llogarinë bankare llogaritjen e bën banka me shpenzimet e debitorit. Në rastet ku llogaritjen e bën banka, organi përmbarues obligohet që në urdhrin përmbarimor të shënojë shkallën e saktë të kamatës, udhëzimet e sakta për kohën e llogaritjes së kamatës, si dhe të gjitha detajet e tjera të nevojshme, në mënyrë që bankave t'iu mundësohet kalkulimi i kamatës në mënyrë të saktë. Në rast se në urdhrin përmbarimor ka informata të pamjaftueshme, të paqarta, apo të pakompletuara, lidhur me llogaritjen e kamatës, organi përmbarues obligohet që të plotësojë urdhrin përmbarimor, sipas kërkesës së bankave."

Neni 73
Vendosja sipas prapësimit

1. Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga Gjykata.

1a. Gjykata vendos për prapësimin në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të prapësimit.

2. Vendimi për prapësim nxirret nga një gjyqtar i vetëm.

3. Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar.

4. Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera.

Neni 77
Ankesa kundër vendimit lidhur me prapësimin

1. Palët kanë të drejtë ankese kundër vendimit mbi prapësimin.
2. Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7)ditëve nga dita e pranimit.
3. Një kopje e ankesës u dorëzohet palës kundërshtare dhe pjesëmarrësve tjerë të cilët mund të paraqesin përgjigje në ankesë në afat prej tre (3)ditëve.
4. Pas pranimit të përgjigjes në ankesë ose pas kalimit të afatit për përgjigje, lënda së bashku me të gjitha shkresat tjera i dërgohet Gjykatës së shkallës së dytë në afat prej tre(3) ditësh. Lidhur me ankesën, Gjykata e shkallës së dytë do të vendosë në afat prej pesëmbëdhjetë(15)ditëve.
5. Ankesa kundër vendimit nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 të këtij ligji.
6. Në rast se debitori si palë ankuese është i suksesshëm në ankesën e tij dhe nëse pasuria e tij është përmbaruar në pajtim me vendimin

përmbarimore, ai mund të kërkoj kundër përmbarim sipas dispozitave të këtij ligji për kundër përmbarimin.

Neni 79

Ankesat kundër parregullsive me rastin e kryerjes së përmbarimit

1. Pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë mund të parashtrojë një ankesë në Gjykatë, lidhur me parregullsitë që janë kryer nga organi përmbarues gjatë kryerjes së procedurës së përmbarimit. Kjo ankesë i bëhet Gjykatës me një parashtresë me shkrim në afat prej shtatë (7) ditësh nda dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar.
2. Sipas ankesës nga paragrafi 1.i këtij neni, nëse parashtruesi e ka propozuar këtë, Gjykata nxjerr vendimin brenda tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të parashtresës.
3. Palët ose pjesëmarrësit tjerë në procedurë kanë të drejtë ankese kundër vendimit të përmendur në paragrafin 2.të këtij neni në pajtim me dispozitat e nenit 77 të këtij ligji.

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 5

5.1 Gjykata do t'i jep mundësi secilës palë që të deklarohet rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare.
5.2 Vetëm në rastet e përcaktuara me këtë ligj gjykata ka drejtë që të vendos mbi kërkesën për të cilën palës kundërshtare nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet.

Shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimi
Neni 181

181.1 Aktgjykimi mund të goditet:
a) për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore;
b) për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike;
c) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
181.2 Aktgjykimi në bazë të pohimit dhe aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia mund të goditen për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkaku se deklarata e pohimit, gjegjësisht e heqjes dorë nga kërkesëpadia, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.

Neni 182

182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejt ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

[...]

h) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata ka nxjerr aktgjykim për shkak të pohimit, mosbindjes, mungesës, heqjes dorë nga kërkesëpadia, ose pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor;

i) në qoftë se ndonjërës nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë;

[...]

n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit,
apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;
o) në qoftë se me aktgjykim është tejkaluar kërkesëpadia.
[...].

Vendimet e gjykatës së shkallës së dytë mbi ankesën
Neni 195

195.1 Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj :
a) ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme;
b) ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë;
c) ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;

d) ta refuzoj ankesën si të pathemeltë dhe ta vërtetoj aktgjykimin e goditur;
e) ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.

195.2 Gjykata e shkallës së dytë nuk është e lidhur për propozimin e parashtruar ne ankesë.

[...]

Neni 247

247.1 Prokurori publik mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë:

a) për shkak te shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale , po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore;
b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.
[...]

Neni 357

357.1 Pala e cila e propozon ekspertizën ka për detyrë që në propozimin e saj ta tregojë objektin dhe vëllimin e ekspertizës dhe ta propozojë personin që do ta bëjë ekspertizën.
357.2 Palës kundërshtare duhet dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me ekspertizën e propozuar.
357.3 Po që se palët nuk merren vesh për personin që do të bëjë ekspertizën si dhe për objektin dhe vëllimin e tij, vendimin për këtë do ta jep gjykata.

Vlerësimi i pranueshmërisë kërkesës

87. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

88. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

89. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

90. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë. (Shih, rastin e Gjykatës KI41/09, me parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; KI35/18, me parashtrues "*Bayerische Versicherungsverbrand",* Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40, dhe KI227/19, me parashtrues N.T. "*Spahia Petrol",* Aktgjykim i 20 dhjetorit 2020, paragrafi 37).

91. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenin 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcakton:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë

cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

92. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [CML.nr.12/20] i 20 janarit 2020 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

93. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

94. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [CML.nr.12/20] e 20 janarit 2020 të Gjykatës Supreme, me të cilën ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit, ndaj Aktvendimit [Ac.nr.3610/20] të 8 tetorit 2020, të Gjykatës së Apelit, e cila kishte refuzuar si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kishte vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore [PPP.nr.1486/19].

95. Gjykata rikujton që kërkesa parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me procedurën e përmbarimit të zhvilluar kundër parashtruesit të kërkesës lidhur me përmbarimin e vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit [OEN nr.20990/MHM] të cekur më lart. Lidhur me këtë, duke vepruar sipas kërkesës së kompanisë "Dardafon" përmbaruesi privat Ilir Mulhaxha, kishte nxjerr Urdhrin përmbarimor

[P.nr.491/19] të 15 korrikut 2019, me të cilin urdhëroi përmbarimin e vendimit përfundimtar të Tribunalit të Arbitrazhit dhe shpenzimet tjera procedurale. Ndaj Urdhrit përmbarimor [P.r.491/2019], parashtruesi i kërkesës më 18 korrik 2019, kishte bërë Prapësim në Gjykatën Themelore, ku kjo e fundit më 22 qershor 2020 kishte mbajtur seancë dëgjimore me ç'rast kishte nxjerr Konkluzion me të cilin detyroi kompaninë "Dardafon" që në afat pre (tre) 3 ditësh të parashtroj në Gjykatën Themelore parashtresë për precizimin e propozimit për përmbarim dhe atë lidhur me shumën e përgjithshme të borxhit kryesor. Më 25 qershor 2020 (*të regjistruar në Gjykatën Themelore më 29 qershor 2020*), kompania "Dardafon" dorëzoi Plotësimin e Propozimit për Përmbarim, në Gjykatën Themelore në shumë të përgjithshme prej 24,684,003.15 euro, duke i shtuar kamatën ligjore. Kompania "Dardafon" gjithashtu dorëzoi një Raport të Auditorit Ligjor, lidhur me kalkulimin e shumës së lartcekur dhe prova lidhur me pagesat e kryera ndaj parashtruesit të kërkesës. Dokumentet e lartcekura, parashtruesi i kërkesës deklaron se i kishte pranuar më 6 korrik 2020. Më 7 korrik 2020, parashtruesi i kërkesë deklaron se kishte dorëzuar Deklarimin në Plotësimin e Propozimit për Përmbarim të kompanisë "Dardafon", të cekur më lart, duke kërkuar, mes tjerash, që të pranohet si i bazuar Prapësimi i parashtruesit të kërkesës ndërsa propozimi për përmbarim të konsiderohet i tërhequr. Mirëpo më 6 korrik 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP.nr.1486/19] kishe aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin lidhur me shumën prej 315,99.85 euro dhe kishte refuzuar si të pabazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me shumën prej 24,684,003.15 euro, dhe lidhur me këtë shumë, vendosi që të mbetet në fuqi Urdhri përmbarimor P.nr.491/2019.

96. Parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore [PPP.nr.1486/19] të 6 korrikut 2020, kishe paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurën përmbarimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të anuloj Aktvendimin e Gjykatës Themelore PPP.nr.1486/19 të 6 korrikut 2020, dhe çështjen ta rikthen në rigjykim në Gjykatën Themelore. Parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se me datën 22 qershor 2020 lidhur me shqyrtimin e Prapësimit të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata kishte marrë Konkluzion me të cilin kishte detyruar kompaninë "Dardafone" që brenda (3) tri ditësh të precizoj propozimin për përmbarim. Më 6 korrik 2020 parashtruesi i kërkesës deklaroi se kishte pranuar parashtresën e kompanisë "Dardafon" - Precizimin e Propozimit për Përmbarim. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se përveç Precizimit

të Propozimit për Përmbarim, kompania "Dardafon" kishte dorëzuar edhe një ekspertizë financiare, e cila nuk ishte urdhëruar nga gjykatat, si dhe një numër të konsiderueshëm të faturave dhe debit notave dhe të cilat nuk ishin dorëzuar ndonjëherë parashtruesit kërkesës me qëllim të deklarimit eventual rreth konstatimeve në këtë ekspertizë dhe deklarimit rreth faturave dhe debit notave. Parashtruesi i kërkesës më 7 korrik 2020, deklaroi se kishte dorëzuar *"Deklarimin rreth Parashtresës së Kreditorit"* për Precizimin e Propozimit për Përmbarim. Parashtruesi kërkesës pretendoi para Gjykatës së Apelit se Gjykata Themelore, mes tjerash, nuk kishe marrë fare për bazë parashtresën e parashtruesit të kërkesës pasi, sipas tij, Aktvendimi [PPP.nr.1486/19] i Gjykatës Themelore ishte i gatshëm një ditë përpara, pra më 6 korrik 2020, pa shqyrtuar qëndrimin e parashtruesit të kërkesës rreth Precizimit të Propozimit për Përmbarim të kompanisë "Dardafon" dhe dokumentet tjera përcjellëse, dhe duke shkelur kështu dispozitat ligjore dhe duke mohuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për tu deklaruar rreth pretendimeve të kompanisë "Dardafon", konform nenit 182.2 (i) të LPK-së, aq më tepër kur bëhet fjalë për pretendime dhe dokumente të reja. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3610/20] të 8 tetor 2020, kishte refuzuar si të pathemeltë ankesë e parashtruesit të kërkesës dhe kishte vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore [PPP.nr.1486/19]. Pas propozimit të parashtruesit të kërkesës Zyra e Prokurorit të Shtetit kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, me ç'rast kjo e fundit kishte refuzuar këtë kërkesë. Mes tjerash, Gjykata Supreme kishte arsyetuar se mbajtja e seancës dëgjimore nuk ishte obligim ligjor për Gjykatën Themelore dhe në rastin konkret nuk ishte e nevojshme që të mbahet edhe një seancë shtesë gjyqësore pas pranimit të precizimit për propozimit për përmbarim të kompanisë Dardafon. Gjykata Supreme gjithashtu deklaroi se fakti se kompania "Dardafon" ka dorëzuar një ekspertizë kur ka precizuar shumë e borxhit, nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e procedurës, aq më pak kur palët kanë nënshkruar një marrëveshje për përmbushjen me këste të detyrimit.

97. Parashtruesi i kërkesës pretendon para Gjykatës Kushtetuese se: *a)* Gjykata Themelore në Aktvendimin [PPP.nr.1486/19], i kishte mohuar parashtruesit të kërkesës të drejtën ligjore të garantuar me nenet 5 (1) dhe 357(2) të LPK-së që të deklarohet lidhur me parashtresën e kompanisë "Dardafon" për Precizimin e Propozimit të Përmbarimit dhe dokumenteve dhe provave shtesë të dorëzuar (ekspertizën dhe faturat e debit notave) pasi, sipas tij, Aktvendimi i Gjykatës Themelore [PPP.nr.1486/19] ishte i gatshëm një ditë përpara se parashtruesi i kërkesës të dorëzoj përgjigjen e tij; dhe *b)* Gjykata Themelore, në kundërshtim me ligjin nuk kishte mbajtur shqyrtim

gjyqësor me qëllim që parashtruesit të kërkesës ti jepet mundësia që të deklarohet rreth propozimit të ri dhe provave të reja të paraqitura nga kompania "Dardafon".

98. Për arsye të lartcekurave, parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur dispozitat e procedurës dhe nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 KEDNJ-së, përkatësisht *"elementet thelbësore të nocionit "gjykim i drejtë" [...] a) parimi i kontradiktoritetit; b) parimi i "barazisë së armëve"; dhe c) e drejta në vendim të arsyetuar".*

99. Rrjedhimisht Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për (i) për shkeljen e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, duke vazhduar më pas me pretendimin për (ii) mos-mbajtjen e seancës dëgjimore.. Gjykata do bazohet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. PRETENDIMET LIDHUR ME PARIMIN E KONTRA-DIKTORITETIT DHE BARAZINË E ARMËVE

i) Parimet e përgjithshme për kontradiktoritetin dhe barazinë e armëve

100. Gjykata fillimisht sqaron se parimi i *"barazisë së armëve"* është element i një koncepti më të gjerë të një gjykimi të drejtë që kërkon *"ekuilibër të drejtë midis palëve"* ku secilës palë i jepet mundësi e arsyeshme të paraqes rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në disavantazh substancial *vis-a-vis* palës kundërshtare. (shih rastin e GJEDNJ *Yvon kundër Francës,* Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31, *dhe rastin e GJEDNJ Dombo Beheer B.V. kundër Holandës,* Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33; shih *mutatis mutandis,* po ashtu rastin e Gjykatës KI31/17, parashtrues Shefqet Berisha, Aktgjykim i 30 majit 2017*,* paragrafi 70*).*

101. Parimi i kontradiktoritetit procedural në anën tjetër, nënkupton që palët në procedurë duhet të kenë dijeni dhe mundësi të komentojnë dhe kundërshtojnë pretendimet dhe provat që paraqitën gjatë shqyrtimit gjyqësor (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Brandstetter v. Austria*, nr. 11170/84, Aktgjykimi i 29 gushtit 1991; *Vermeulen kundër Belgjikës*, nr. 19075/91, Aktgjykimi i 20 shkurtit

1996 KI193/19, parashtrues *Salih Mekaj,* Aktgjykim i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 47).

102. Duke u referuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata potencon se parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural janë të lidhur ngushtë dhe në shumë raste GJEDNJ i ka trajtuar së bashku (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Rowe and Dawis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 18990/91; Aktgjykimi i vitit 2000, *Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr, 27052/95, Aktgjykimi i vitit 2000; *Zahirović kundër Kroacisë*, nr. 58590/, Aktgjykimi i 25 korrikut 2013 KI193/19, parashtrues *Salih Mekaj,* cituar më lart, paragrafi 48).

103. Kërkesa e "barazisë së armëve", në kuptimin e një "ekuilibri të drejtë" midis palëve, vlen në parim për raste civile si dhe për raste penale (shih rastin e Gjykatës KI10/14, parashtrues, *Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank Kosove SH. A.*, Aktgjykim i 20 majit 2014, paragrafi 42; dhe rastin e Gjykatës KI31/17, parashtrues *Shefqet Berisha* cituar më lart, paragrafi 71).

104. GJEDNJ ka theksuar se sipas parimit të "barazisë së armëve", është e papranueshme që një palë në procedurë të paraqesë vërejtje apo komente para gjykatave të rregullta, të cilat kanë për qëllim që të ndikojnë në vendimmarrjen e gjykatës, pa dijeninë e palës tjetër dhe pa i dhënë mundësi palës tjetër të përgjigjet në to. I takon palës së përfshirë në procedurë pastaj të vlerësojë nëse vërejtjet apo komentet e paraqitura nga pala tjetër meritojnë reagim. (shih rastin e GJEDNJ *APEH Üldözötteinek Szövetsége and others kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 5 janarit 2011, paragrafi 42; shih gjithashtu, rastin e GJEDNJ *Guigue and SGEN-CFDT kundër Francës*, Vendim i 13 korrikut 2000).

105. Andaj, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, parimi i "barazisë së armëve" cenohet kur ankesa e palës kundërshtare nuk i është komunikuar parashtruesit të kërkesës dhe ai nuk është informuar për një ankesë të tillë përmes ndonjë mënyre tjetër. (shih rastin e GJEDNJ *Beer kundër Austrisë*, Aktgjykim i 6 shkurtit 2001, paragrafi 19, shih gjithashtu rastin e GJEDNJ GJEDNJ *Andersena kundër Letonisë*, Aktgjykim i 19 shtatorit 2019, paragrafi 87). Ngjashëm, GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të këtij parimi në rast kur vetëm një nga dy dëshmitarët kyç është lejuar që të dëshmojë (shih rastin *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës, cituar më lartë, paragrafi 34 dhe 35).*

106. GJEDNJ po ashtu kishte konstatuar shkelje të parimit të "barazisë së armëve" për shkak të pozicionit të prokurorit të përgjithshëm në

procedurën para Gjykatës së Auditimit, që për dallim nga palët në procedurë, prokurori i përgjithshëm ishte i pranishëm në seancë, ishte i informuar paraprakisht për pikëpamjen e gjyqtarit raportues, merrte pjesë plotësisht në debate dhe kishte mundësinë të shprehte me gojë pikëpamjen e tij pa u kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse, dhe kjo mungesë ekuilibri theksohej nga fakti se seanca nuk ishte publike. Kjo për GJEDNJ-në kishte ngritur çështjen e mos-balancës në mes të palëve në procedurë. (shih rastin e GJEDNJ *Martinie kundës Francës*, Aktgjykim i 12 prillit 2006, paragrafi 50).

107. GJEDNJ kishte gjetur shkelje të parimit të "barazisë së armëve" edhe në rastin *Yvon kundër Francës* kur komisionari i Qeverisë, merrte pjesë në procedurë gjyqësore për përcaktimin e shumës së shpronësimit, së bashku me autoritetin e shpronësimit kundër palës tjetër prona e të cilit ishte subjekt shpronësimi. GJEDNJ kishte konstatuar në këtë rast se pala e shpronësuar ishte ballafaquar jo vetëm me autoritetin e shpronësimit por edhe me komisionarin e Qeverisë, ku këta të fundit kanë pasur përparësi të dukshme për qasje në dokumente në raport me palën e shpronësuar. Për më tepër, komisionari i Qeverisë, që ishte edhe ekspert edhe palë në procedurë, kishte qenë në pozicion dominues dhe kishte mundësi për të ushtruar një ndikim të madh në vlerësimin e gjyqtarit. Kjo për GJEDNJ-në kishte ngritur çështjen e mos-balancës *vis a vis* palës së shpronësuar që ishte e papajtueshme me parimin e *"barazisë së armëve"*. (shih rastin e GJEDNJ *Yvon kundër Francës,* Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 37).

108. Për më tepër, GJEDNJ në rastin *De Haes and Gijsels kundër Belgjikës* kishte konstatuar shkelje të parimit të "barazisë së armëve" kur pala kundërshtare ka qenë në një pozicion ose funksion që e ka favorizuar atë *vis a vis* palës tjetër, për shkak të mundësisë që vetëm njëra palë të ketë qasje në dokumentet relevante e të cilat ndërlidheshin me rastin konkret. Pra në rastin *De Haes and Gijsels kundër Belgjikës*, dy gazetarë të revistës Humo, ishin gjobitur nga një gjykatë civile pasi në disa artikuj të publikuar, gazetarët kishin akuzuar disa gjyqtar se ata kanë qenë të anshëm në një rast kur ata kishin vendosur që kujdesi lidhur me fëmijët e një çifti ti takonte vetë njërit prind. Në paditë e tyre kundër gazetarëve, gjyqtarët ishin referuar edhe në dosjen e rastit lidhur me kujdestarinë e fëmijës të cilën ata vet e kishin trajtuar, por dokumentet në dosje nuk ishin të qasshme për gazetarët. Andaj, gazetarët ishin ankuar para GJEDNJ, mes tjerash për shkelje të parimit të "barazisë së armëve" me pretendimin se artikujt e publikuar ishin të bazuara në dokumente të cilat ishin të qasshme për gjyqtarët por që gjykatat e rregullta të Belgjikës, përkundër kërkesës së gazetarëve, nuk u kishin lejuar atyre qasje në to, sidomos në opinion

e tre (3) profesorëve, me çka gazetarët do të dëshmonin pretendimet e tyre se në fakt gjyqtarët ishin të anshëm dhe nuk e kishin trajtuar rastin lidhur me kujdestarinë e fëmijës në mënyrën e duhur. GJEDNJ, duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesve të kërkesës që kishin kërkuar nga gjykatat belge qasje në opinionin e tre (3) profesorëve, erdhi në përfundim se gjykata belge duke refuzuar kërkesën e gazetarëve për qasje në dosjen në të cilën kishin vendosur gjyqtarët në fjalë kishte vendosur gazetarët në pozitë substancialit të disfavorshme *vis a vis*, palës tjetër, në këtë rast gjyqtarëve në cilësi të tyre si paditës. Për këto arsye GJEDNJ kishte gjetur shkelje të parimit të barazisë së armëve të garantuar me nenin 6 të KEDNJ. *(*shih rastin e GJEDNJ *De Haes and Gijsels kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 24 shkurtit 1997, paragrafët 54 deri 58*)*.

109. Megjithatë, GJEDNJ ka theksuar e drejta e palëve lidhur me të drejtë për një gjykim të drejtë duke përfshirë edhe parimin e "barazisë së armëve" nuk është absolute. Shtetet gëzojnë një margjinë të caktuar të vlerësimit në këtë aspekt. Por, i takon GJEDNJ-së që të vendos në instancë të fundit nëse këto parime respektohen (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Regner kundër Republikës Çeke,* Aktgjykim i 19 shtatorit 2017, paragrafi 147).

110. Në këtë aspekt, GJEDNJ, përmes praktikës së saj ka përcaktuar që një parregullsi në proces, në disa kushte, mund të korrigjohet në një stad të mëvonshëm ose në nivelin e njëjtë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Helle kundër Finlandës,* Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 54) ose, nga një gjykatë më e lartë (shih rastet e GJEDNJ-së, *Schuler-Zgraggen kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 24 qershorit 1993, paragrafi 52 ; dhe, e kundërta , *Albert et Le Compte kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 10 shkurtit 1983, paragrafi 36 ; si dhe *Feldbrugge kundër Holandës,* Aktgjykim i 29 majit 1986, paragrafët 45-46).

111. Në rastin *Helle kundër Finlandës*, z. Helle kishte argumentuar në parashtresën e tij se ai ishte vendosur në disavantazh për faktin se Trupës Katedrale (Cathedral Chapter) iu kërkua në dy raste nga Gjykata e Lartë Administrative për të dhënë mendimin e saj mbi bazueshmërinë e ankesave të tij. GJEDNJ, theksoi se nuk pajtohet me pohimin e z. Helle sepse çdo paragjykim i mundshëm që mund të ishte shkaktuar për rezultatin e apelit të tij u kompensua nga fakti që atij iu dha një mundësi e mirëfilltë nga Gjykata e Lartë Administrative për të paraqitur komentet e tij mbi përmbajtjen e mendimeve të Trupës Katedrale. Z. Helle e shfrytëzoi këtë mundësi në dy raste dhe në këto rrethana GJEDNJ gjeti se z. Helle nuk mund të pohojë se kishte shkelje të kërkesës së "barazisë së armëve" të qenësishme në konceptin

e një procedure të drejtë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Helle kundër Finlandës,* Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 54).

112. Në rastin *Schuler-Zgraggen kundër Zvicrës*, GJEDNJ gjeti se procedurat para Bordit të Apelimit nuk i mundësuan znj. Schuler-Zgraggen të kishte një pamje të plotë dhe të hollësishme të veçorive të dhëna Bordit. Megjithatë, GJEDNJ konsideroi që Gjykata Federale e Sigurimeve e rregulloi këtë mangësi duke kërkuar nga Bordi të vinte në dispozicion të kërkuesit të gjitha dokumentet - i cili ishte në gjendje, ndër të tjera, të bënte kopje - dhe më pas t'ia përcillte dosjen avokatit të kërkuesit. Rrjedhimisht GJEDNJ, konstatoi se meqenëse, marrë në tërësi, procedurat e kundërshtuara ishin të drejta, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së në këtë drejtim(shih rastin e GJEDNJ-së, *Schuler-Zgraggen kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 24 qershorit 1993, paragrafi 52).

113. Për ndryshim në rastin *Albert et Le Compte kundër Belgjikës*, GEJDNJ gjeti shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, për arsye se karakteri publik i procedurave të kasacionit nuk mjafton për të rregulluar defektin e konstatuar se ekziston në fazën e procedurave disiplinore. Gjykata e Kasacionit nuk merr parasysh trajtimin e meritave të rastit, që do të thotë se shumë aspekte të "kontestimeve" (mosmarrëveshjeve) në lidhje me *"të drejtat dhe detyrimet civile",* duke përfshirë shqyrtimin e fakteve dhe vlerësimin e proporcionalitetit midis fajit dhe sanksionit, bie jashtë juridiksionit të tij (shih rastin e GJEDNJ-së, *Albert et Le Compte kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 10 shkurtit 1983, paragrafi 36). Në *Feldbrugge kundër Holandës,* GJEDNJ gjeti shkelje për faktin se znj. Feldbrugge nuk kishte kushtet për qasjen në dy Bordet përkatëse me çka ajo nuk mundi të sfidojë meritat e vendimit të Presidentit të Bordit të Apelimit. Rrjedhimisht, mangësia e gjetur në këtë aspekt të procedurës para zyrtarit gjyqësor nuk mund të rregullohej në stad të mëvonshëm. *Feldbrugge kundër Holandës,* Aktgjykim i 29 majit 1986, paragrafët 45-46).

114. Rrjedhimisht, GJEDNJ ka konstatuar në praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore se defektet në instancë të parë mund të përmirëson përmes institucionit të ankesës, me kusht që institucioni që vendos për ankesë, të ketë "juridiksion të plotë". Sipas GJEDNJ-së ankesa ka të bëjë me pretendimin për mos-komunikim të dokumentin, koncepti i "juridiksionit të plotë" nënkupton që gjykata që e shqyrton ankesën jo vetëm që duhet të ketë të drejtë të vlerësoj ankesën, por po ashtu duhet të ketë kompetencë që të prish vendimin në fjalë dhe ose të merr vendimin vet apo të kthej rastin për një vendim të ri nga një trupë e pavarur (Shih rastet e GJEDNJ, *M.S. kundër Finlandës*,

Aktgjykim i 22 qershorit 2005, paragrafi 35; *Köksoy kundër Turqisë*, Aktgjykim i 13 janarit 2021, paragrafi 36; *Bacaksiz kundër Turqisë*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2019, paragrafi 59).

ii) Aplikimi i parimeve të shtjelluara më lart lidhur me pretendimin se parashtruesit i ishte mohuar të deklarohet lidhur me parashtresën e kompanisë "Dardafon" për Precizimin e Propozimit të Përmbarimit dhe dokumenteve dhe provave shtesë

115. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, pretendon se në rastin e tij nuk janë respektuar "parimi i kontradiktoritetit" dhe i "barazisë së armëve", pasi atij i është mohuar deklarimi lidhur me parashtresën për Precizimin e Propozimit për Përmbarim dhe dokumentet shtesë, duke përfshirë edhe një ekspertizë e cila nuk ishte urdhëruar nga gjykatat, të paraqitur nga kompania "Dardafon".

116. Parashtruesi i kërkesës pretendon që ka pranuar parashtresën për precizimin e borxhit nga ana e kreditorit me datën 6 korrik 2020, dhe i njëjti ka parashtruar përgjigje me 7 korrik 2020. Përkundër që sipas parashtruesit, Gjykata i kishte dorëzuar precizimin e borxhit dhe dokumente tjera, deklarimi i tij lidhur me parashtresën, nuk ishte pranuar dhe shqyrtuar nga Gjykata Themelore, sepse kjo e fundit tashmë kishte vendosur lidhur me rastin e tij.

117. Lidhur me këtë, Gjykata vëren nga shkresat e lëndës se Gjykata Themelore ka nxjerrë Aktvendimin PPP.nr. 1486/19, më 6 korrik 202, sipas parashtruesit një ditë përpara se parashtruesi i kërkesës të dorëzonte përgjigjen e tij për parashtresën e kreditorit. Gjykata vëren se Gjykata Themelore kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës për parashtresën, mirëpo nuk kishte përfshirë argumentet e tij në vendimin e saj. Lidhur me argumentet e parashtruesit, të parashtruara në këtë fazë, Gjykata rikujton se i njëjti, ishte ankuar në lidhje me parashtresën e Kreditorit si nga aspekti formal dhe ai material. Parashtruesi ishte ankuar se Precizimi i Propozimit të Përmbarimit ishte dorëzuar me 4 ditë vonesë andaj, Propozimi do të duhet të deklarohej i jashtë afatshëm. Këtë të fundit parashtruesi nuk e ngrit para Gjykatës Kushtetuese. Sa i përket kundërshtimit në aspektin material, parashtruesi i kërkesës lidhur me vlerën e re 24,684,003.15 €, e kontestoi me arsyetimin që (i) nuk figuron në Vendimin final të Tribunalit të Arbitrazhit të OEN 20990/MHM të 9 dhjetorit 2016; (ii) Nuk figuron në Propozimin për Përmbarim të Kreditorit të 15 korrikut 2019; (iii) për këtë vlerë nuk është lëshuar urdhëri përmbarimor P.nr.

491/19 i 15 korrikut 2019; dhe (iv) për këtë vlerë nuk është ushtruar prapësimi i debitorit.

118. Gjykata vëren se Gjykata Themelore në vendosjen e saj me Aktvendimin PPP.nr. 1486/19, duke mos shqyrtuar argumentet e parashtruesit të kërkesës lidhur me Precizimin e Propozimit për Përmbarim si dhe dokumentet tjera të dorëzuara nga pala tjetër në këtë rast është problematike, duke marrë për bazë praktikën gjyqësore të saj dhe të GJEDNJ-së si dhe dispozitat ligjore të LPK, konkretisht nenin 5.1 që përcakton se *"Gjykata do t'i jep mundësi secilës palë që të deklarohet rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare."* si dhe nenin neni 357.2 të LPK-së që përcakton se *"Palës kundërshtare duhet dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me ekspertizën e propozuar."*

119. Në këtë aspekt, sipas parimeve të vendosura nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe GJEDNJ-së të sqaruar më lart por edhe sipas legjislacionit në fuqi, gjykatat e rregullta (i) duhet të u japin mundësi palëve si dhe (ii) duhet të bëjnë shqyrtim të mirëfilltë të parashtresave, të argumenteve dhe të provave të paraqitura nga palët dhe të vlerësojnë, pa paragjykim, nëse ato janë të rëndësishme dhe me peshë për vendimin e saj.

120. Megjithatë Gjykata vëren gjithashtu se pas pranimit të Aktvendimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte bërë ankesë në Gjykatën e Apelit duke ngritur specifikisht çështjen e mos trajtimi të qëndrimit të parashtruesit lidhur me Precizimin e Borxhit dhe dokumenteve të tjera të palës kundërshtare lidhur me të cilat parashtruesit nuk i ishte dhënë mundësi që këto pretendime të trajtohen nga Gjykata Themelore, pasi Aktgjykimi i Gjykatës Themelore fare nuk ka potencuar faktin që parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar qëndrimin e saj lidhur me Precizimin e Borxhit dhe dokumenteve të tjera të palës kundërshtare.

121. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u mbështetur në praktikën e GJEDNJ-së, po ashtu rikujton se defektet (të metat) në instancën e parë, mund të rregullohet në instancën e dytë (apel), nëse institucioni i apelit ka "juridiksion të plotë" lidhur me çështjen. Lidhur me këtë Gjykata përsërit se kur një ankesë është bërë lidhur me mos-komunikimin e dokumenteve, koncepti i "juridiksionit të plotë" përfshinë jo vetëm faktin që gjykata e apelit ka të drejtë shqyrton ankesën, por gjithashtu nëse e njëjta ka kompetencë për të prishur vendimin e kundërshtuar dhe/ose të marrë vendim vet lidhur me çështjen ose ta kthejë çështjen për vendim të ri nga një organ i paanshëm (shih *mutatis mutandis*

rastin e GJEDNJ-së, *Köksoy kundër Turqisë,* cituar më lart, paragrafi 36; rastin *M.S kundër Finlandës,* cituar më lart, paragrafi 35)

122. Në rastin *Köksoy kundër Turqisë,* GJEDNJ theksoi se fakti që nuk u ishte komunikuar aplikantëve lidhur me provat e marra nga Gjykata e Kasacionit më vetiniciative ngre një problem. Me rastin e apelimit Gjykata e Kasacionit prishi vendimin e gjykatës shkallës së parë, dhe i ktheu të njëjtës rastin për ri-shqyrtim. Parashtruesit në këtë rast nuk pretenduan që dokumentet dhe informacioni në fjalë mbështetur nga Gjykata e Kasacionit nuk ishte i disponueshëm për ta pasi ata mësuan për përmbajtjen e tyre në vendimin e Gjykatën së Kasacionit. Ankesa e tyre në këtë drejtim është kufizuar në faktin se pikëpamjet e tyre nuk ishin kërkuar nga Gjykata e Kasacionit para vendimit të saj lidhur me ankesën. GJEDNJ, theksoi se në procedurën e ri-kthimit të rastit, gjë që dallon nga rasti i tanishëm pasi i njëjti nuk është rikthyer në rishqyrtim, ankuesit kishin mundësi për të ngritur kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të Gjykatës së Kasacionit. GJEDNJ konstatoi se efektet e mangësisë procedurale në procedurat e apelit ishin korrigjuar në fazën e ri-kthimit për aq kohë sa kërkuesit ishin në gjendje të kishin njohuri për dokumentet dhe informacionet në fjalë pasi që rasti i tyre është rikthyer për ri-konsiderim dhe tutje nga fakti që ankuesit ishin në gjendje t'u përgjigjeshin atyre para trupit gjykues përgjatë seancës. Rrjedhimisht, GJEDNJ konstatoi se nuk ka shkelje të nenit 6 paragrafi 1 sepse mangësia procedurale gjatë shqyrtimit të ankesës në Gjykatën e Kasacionit nuk ndikoi në parimin e kontradiktoritetit në masë të tillë që bëjë procedurat në tërësi të padrejta (Shih rastin e GJEDNJ, *Köksoy kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafët 37-39).

123. Andaj, në vazhdim Gjykata bazuar edhe në praktikën e GJEDNJ-së, do të vlerësojë nëse gjykata që shqyrton ankesën, në këtë rast Gjykata e Apelit kishte juridiksion të plotë lidhur me rastin, konkretisht, nëse kishte mundësinë për të prishur vendimin e kundërshtuar, ose të marrë vendim vet lidhur me çështjen ose ta kthejë çështjen për vendim të ri nga një organ i paanshëm, si dhe të vendosë për të gjitha çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në përgjigjen ndaj Precizimit të Propozimit për Përmbarim, para Gjykatës Themelore.

124. Lidhur me këtë Gjykata vëren se bazuar në nenin 17 të LPP-së, në rast se LPP nuk rregullon çështje të caktuar, gjejnë zbatim dispozitat e procedurës kontestimore ku konkretisht theksohet *"Në procedurën përmbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër."*

125. Në rastin konkret, neni 77 i LPP-së, përcakton që palët kanë të drejtë ankese kundër vendimit mbi prapësimin, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton që ankesa kundër vendimit të shkallës së parë parashtrohet në gjykatën e shkallës së dytë, në këtë rast në Gjykatën e Apelit. Meqenëse neni 77 i LPP-së, nuk specifikon më tepër lidhur me ankesën, Gjykata bazuar në nenin 17 LPP-së, vë në dukje se LPK si ligj që zbatohet përshtatshmërisht përcakton në nenin 195 të saj se vendimet që ndërmerren nga gjykata e shkallës së dytë, në rastin konkret Gjykata e Apelit, janë:

(i) ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme;
(ii) ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë;
(iii) ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;
(iv) ta refuzoj ankesën si të pathemeltë dhe ta vërtetoj aktgjykimin e goditur;
(v) ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.

126. Për më tepër, Gjykata vëren se: bazuar në nenin 181.1 të LPK-së Aktgjykimi mund të goditet në Gjykatën e Apelit dhe atë për:
a) për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore;
b) për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike;
c) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale."

127. Andaj, duke pasur parasysh dispozitën e lartcekur, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka –kompetencë të bëjë shqyrtimin e plotë gjyqësor të vendimeve të Gjykatës Themelore lidhur me çështje përmbarimit, dhe kjo përfshin çështjet e shkeljes së dispozitave materiale; dispozitave procedurale; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve; si dhe ka mundësi për të prishur vendimin e kundërshtuar dhe të marrë vendim ose ta kthejë çështjen për vendim të ri nga një organ i paanshëm.

128. Prandaj, Gjykata konkludon se Gjykata e Apelit kishte juridiksion të plotë të shqyrtojë të gjitha çështjet e faktit dhe të ligjit që lidhen me kontestin para saj, duke përfshirë edhe qëndrimet e parashtruesit lidhur me Precizimin e Propozimit për Përmbarim, si dhe kishte kompetencë të anuloj vendimin e Gjykatës Themelore në të gjitha aspektet, duke përfshirë çështjet e faktit dhe ligjit. Prandaj, Gjykata e Apelit, kualifikohet si një "organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë",

në kuptim të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës.

129. Në këtë kontekst, në vazhdim Gjykata do të vlerësoj nëse Gjykata e Apelit, ka vlerësuar argumentet e parashtruesit të kërkesës lidhur me Precizimin e Propozimit për Përmbarim dhe dokumenteve tjera shtesë të dorëzuara nga kompania "Dardafon" dhe pretendim e saj se Gjykata Themelore nuk i kishte dhënë mundësi që të përgjigjet në precizimin e borxhit gjë që ngrit çështjen e parimit të barazisë së armëve.

130. Gjykata i referohet fillimisht Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, e cila sa i përket shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore, kishte deklaruar se Aktvendimi i Gjykatës Themelore *"nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së."*

131. Gjykata e Apelit, theksoi gjithashtu se "*Duke marrë parasysh pretendimet tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të takuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara, ngase, nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të [LPP] dhe as të [LPK], të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.[...]"*

132. Bazuar në arsyetimin e Gjykatës së Apelit, Gjykata vëren se e njëjta përkitazi me pretendimet qe ndërlidhen me atë se, Gjykata Themelore në Aktvendimin [PPP.nr.1486/19], i kishte mohuar parashtruesit të kërkesës të drejtën ligjore sipas LPK-së që të deklarohet lidhur me parashtresën e kompanisë "Dardafon" për Precizimin e Propozimit të Përmbarim dhe dokumenteve dhe provave shtesë të dorëzuar (ekspertizën dhe faturat e debit notave) pasi, sipas tij, Aktvendimi i Gjykatës Themelore [PPP.nr.1486/19] ishte i gatshëm një ditë përpara se parashtruesi i kërkesës të dorëzoj përgjigjen e tij, Gjykata e Apelit nuk kishte dhënë ndonjë përgjigje specifike në vendimin e saj. Ajo gjithashtu edhe pse kishte "juridiksion të plotë' lidhur me rastin para saj ashtu siç u përcaktua më lart, nuk kishte shqyrtuar specifikisht pretendimet e paraqitura në përgjigjen e tij lidhur me precizimin e borxhit, duke përfshirë çështjen nëse me këtë rast ishe shkelur parimi i "barazisë së armëve".

133. Ndërsa Gjykata Supreme, lidhur me pamundësinë e deklarimit të parashtruesit të kërkesës për parashtresën e kreditorit edhe

ekspertizën, kishte theksuar se ky pretendim është i pathemeltë. Andaj, duke marrë parasysh pretendimin specifik të parashtruesit të kërkesës lidhur me mos-arsyetimin e vendimit të Gjykatës Themelore dhe shkelje të parimit "barazinë e armëve" dhe "parimit të kontradiktoritetit" si rezultat i mos trajtimit të këtij pretendimi, kjo e fundit nuk kishte dhënë ndonjë përgjigje specifike, nëse ky lëshim procedural i Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit kishte rezultuar në shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, duke përfshirë parimin e "barazisë së armëve".

134. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës siç është pretendimi se Gjykata Themelore në Aktvendimin [PPP.nr.1486/19], i kishte mohuar parashtruesit të kërkesës të drejtë ligjore sipas nenit 5 (1) dhe 357 (2) të LPK-së që të deklarohet lidhur me parashtresën e kompanisë "Dardafon" për precizimin e propozimit të përmbarim dhe dokumenteve dhe provave shtesë të dorëzuar (ekspertizën dhe faturat e debit notave) pasi, sipas tij, Aktvendimi i Gjykatës Themelore [PPP.nr.1486/19] ishte i gatshëm një ditë përpara se parashtruesi i kërkesës të dorëzoj përgjigjen e tij, Gjykata e Apelit nuk kishte dhënë ndonjë përgjigje specifike në vendimin e saj. Andaj, mos korrigjimi i këtij lëshimi procedural i nga Gjykata e Apelit, ngreh çështje të rëndësishme të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, që ngërthen në vete parimin e "barazisë së armëve" si njëri nga parime themelore të një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, duke pasur parasysh parashtruesit i ishte mohuar parashtruesit e drejtë ligjore sipas nenit 5 (1) dhe 357 (2) të LPK-së që të deklarohet lidhur me parashtresën e kompanisë "Dardafon" për precizimin e propozimit të përmbarim dhe dokumenteve dhe provave shtesë të dorëzuar (ekspertizën dhe faturat e debit notave), dhe ky lëshim procedural nuk ishte mënjanuar nga Gjykata e Apelit pasi as kjo e fundit nuk kishte shqyrtuar specifikisht këto pretendime.

135. Me këtë rast parashtruesi i kërkesës ishte vendosur në pozitë të pabarabartë në raport me palën kundërshtare pasi kjo e fundit kishte paraqitur Precizimin e Borxhit dhe dokumente tjera mbështetëse, si çështje thelbësore në një procedurë përmbarimi, siç është rasti konkret, pasi nga ajo varej edhe shuma monetare që duhet paguar parashtruesi i kërkesës, ndërsa përgjigjen e parashtruesit të kërkesës lidhur me të njëjtën nuk e kishte konsideruar në mënyrës specifike Gjykata Themelore. Ndërsa Gjykata e Apelit nuk kishte trajtuar specifikisht e as nuk kishte mënjanuar këtë mangësi procedurale të Gjykatës Themelore, megjithëse ky ishte ndër pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës para Gjykatës së Apelit.

136. Gjithashtu, Gjykata Supreme, me gjithë listën e kufizuar të çështjeve që Prokurori publik mund të ngrit para Gjykatës Supreme përmes kërkesës për mbrojte të ligjshmërisë, konform neni 247 të LPK-së, kjo e fundit nuk kishte trajtuar këtë pretendim të parashtruesit për shkelje procedurale duke përfshirë nenin 5 pikën 5. 1 dhe nenin 357, paragrafi 2 të LPK-së që përcakton se *"Palës kundërshtare duhet dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me ekspertizën e propozuar."* dhe në këtë aspekt kjo mund të cenoj "parimin e barazisë" së armëve, i garantuar me nenin 31 të Kushtetutës. Lidhur me pamundësinë e deklarimit të parashtruesit të kërkesës për parashtresën e debitorit edhe ekspertizën, Gjykata Supreme ishte mjaftuar me arsyetimin se ky pretendim është i pathemeltë, pasi, mes tjerash, *"as me parashtresë dhe as me ekspertizën e pretenduar nuk është ndryshuar përmbajtja e kredisë/kërkesës e caktuar në dokumentin përmbarimor, i cili paraprakisht e ka kaluar edhe procedurën e njohjes"*.

137. Në këtë kontekst, Gjykata ka ripërsëritur se sipas parimit të "barazisë së armëve", është e papranueshme që një palë në procedurë të paraqesë vërejtje apo komente para gjykatave të rregullta, të cilat kanë për qëllim që të ndikojnë në vendimmarrjen e gjykatës, pa dijeninë e palës tjetër dhe pa i dhënë mundësi palës tjetër të përgjigjet në to. I takon palës së përfshirë në procedurë pastaj të vlerësojë nëse vërejtjet apo komentet e paraqitura nga pala tjetër meritojnë reagim. (shih rastin e GJEDNJ *APEH Üldözötteinek Szövetsége and others kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 5 janarit 2011, paragrafi 42; shih gjithashtu, rastin e GJEDNJ *Guigue and SGEN-CFDT kundër Francës*, Vendim i 13 korrikut 2000).

138. Prandaj, në rastin konkret duke marrë parasysh arsyet e lartcekuara, Gjykata konsideron që Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, janë nxjerrë në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse kanë dështuar të mënjanojnë lëshimin procedural që ngrit çështjen e parimit për "barazinë e armëve" përkitazi me atë se, Gjykata Themelore në Aktvendimin [PPP.nr.1486/19], i kishte mohuar parashtruesit të kërkesës të drejtën që të deklarohet lidhur me parashtresën e kompanisë "Dardafon" për precizimin e propozimit të përmbarim dhe dokumenteve dhe provave shtesë të dorëzuar (ekspertizën (e cila nuk ishte urdhëruar nga gjykatat) dhe faturat e debit notave). Kjo pasi, Aktvendimi i Gjykatës Themelore [PPP.nr.1486/19] ishte i gatshëm një ditë përpara se parashtruesi i kërkesës të dorëzoj përgjigjen e tij dhe për këtë nuk kishte dhënë ndonjë përgjigje specifike në vendimin e saj.

139. Në këtë kontekst, përveç parimeve tjera, rëndësi i kushtohet edhe dukjes dhe ndjeshmërisë së administrimit të duhur të drejtësisë. Prandaj, duke pasur parasysh këto lëshime procedurale dhe rëndësinë që ka trajtimi i pretendimeve thelbësore të parashtruesve të kërkesës, Gjykata gjen se në rastin e parashtruesit të kërkesës, për shkak të këtij lëshimi procedural ndaj parashtruesit të kërkesës, procedura, shikuar në tërësinë e saj, nuk ishte e drejtë.

140. Gjykata gjithashtu thekson se ky konkludim i referohet shkeljes së pretenduar kushtetuese. Kësisoj, Gjykata konfirmon se gjetjet që i përmban ky Aktgjykim nuk paragjykojnë në as një mënyrë rezultatin e procedurës në lidhje me rastin e parashtruesi të kërkesës.

141. Duke pasur parasysh që Gjykata sapo konstatoi shkeljen e të drejtës së parashtruesit për një gjykim të drejtë dhe rasti duhet të rishqyrtohet sërish nga Gjykata e Apelit, nuk është e nevojshme që të trajtohen pretendimet tjera të parashtruesit të kërkesës.

Kërkesa për masë të përkohshme

142. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kërkon nga Gjykata që të nxjerrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme në mënyrë që të pezullohet menjëherë zbatimi i përmbarimit ndaj parashtruesit të kërkesës sipas Urdhrit Përmbarimor [P.nr. 491/19] të 15 korrikut 2019 të Përmbaruesit privat, dhe Aktvendimit [PPP.nr. 1486/19] të 6 korrikut 2020, të Gjykatës Themelore; Aktvendimit e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3610/20 të 8 tetorit 2020; e Aktvendimit e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.12/20 të 20 janarit 2021.

143. Lidhur me këtë ai ka argumentuar se zbatimi i përmbarimit do të shkaktonte (i) dëm të pariparueshëm për parashtruesin e kërkesës; dhe (i) do ti cenonte interesat shtetërore dhe nacionale nisur nga natyra e veprimtarisë së Telekom-it i cili, në rast të zbatimit të përmbarimit do të falimentonte për shkak të vlerës jashtëzakonisht të madhe të detyrimit.

144. Duke qenë se Gjykata, e shpalli kërkesën të pranueshme dhe gjeti shkeljet e specifikuara në dispozitiv të këtij Aktgjykimi kjo vendimmarrje e bën më tutje të panevojshme shqyrtimin e kërkesës për masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në neneve 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 59 (1) të Rregullores së punës, më 24 nëntor 2021

VENDOS

I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM, me shumicë votash, Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.12/20, të 20 janarit 2021 dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 3610/20 të 8 tetorit 2020;

IV. TË KTHEJË, me shumicë votash, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3610/20 të 8 tetorit 2020, për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TË URDHËROJË Gjykatën e Apelit që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më datën 15 mars 2022 për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;

VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;

VII. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për masë të përkohshme;

VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

IX. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Safet Hoxha	Gresa Caka-Nimani

KO127/21, parashtrues, *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-029, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

KO127/21, Aktgjykim, i 9 dhjetorit 2021, publikuar më 22 dhjetor 2021

Fjalët kyçe: *Kërkesë institucionale, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pavarësi institucionale, pavarësi e anëtarëve, mbikëqyrje e Kuvendit, shkarkim, vendimmarrje, imunitet;*

Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata ka vlerësuar kushtetutshmërinë e Vendimit [nr. 08-V-029], të 30 qershorit 2021, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes të cilit janë shkarkuar pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij akti është parashtruar në Gjykatë nga njëmbëdhjetë (11) deputetë të Kuvendit, bazuar në autorizimet e përcaktuara përmes paragrafit 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Kuvendit, Gjykata njëzëri vendosi që (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) Vendimi [nr.08/V-029] i 30 qershorit 2021 i Kuvendit nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës; (iii) të shfuqizojë Vendimin e lartcekur; (iv) të shfuqizojë Masën e Përkohshme të përcaktuar përmes Vendimit të Gjykatës, të 21 tetorit 2021; dhe (v) të refuzojë kërkesën për seancë dëgjimore.

Gjykata rikujton që më 30 qershor 2021, duke u bazuar në rekomandimin e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, Kuvendi votoi për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Duke kontestuar kushtetutshmërinë e këtij akti, parashtruesit e kërkesës, pretenduan para Gjykatës se Vendimi i kontestuar i Kuvendit, cenon pavarësinë e Këshillit, të garantuar me nenin 101 [Shërbimi Civil] dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, duke theksuar se Këshilli, si organ i pavarur kushtetues, nuk mund t'i nënshtrohet ndërhyrjeve nga ana e Kuvendit dhe se për shkarkimin kolektiv të anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, nuk janë përmbushur asnjë nga kriteret ligjore të përcaktuara përmes Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kundërargumentet e dorëzuara në Gjykatë nga deputetja përkatëse e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje!, në esencë, theksojnë se Kuvendi në nxjerrjen e Vendimit të kontestuar ka vepruar në përputhshmëri me funksionin e tij mbikëqyrës, ndërsa rasti i ngritur para Gjykatës, nuk ngërthen çështje kushtetuese, sepse Kushtetuta nuk përcakton procedurën e zgjedhjes dhe të shkarkimit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

Në vlerësimin e argumenteve dhe kundërargumenteve përkatëse dhe rrethanave që ngërthen rasti, Gjykata (i) fillimisht elaboroi statusin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe anëtarëve të tij, duke u referuar në Kushtetutë, ligjet e aplikueshme dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës; (ii) elaboroi kompetencën e Kuvendit dhe kufizimet përkatëse në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës; dhe në fund (iii) aplikoi këto parime në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Kuvendit.

Përkitazi me pavarësinë institucionale të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, Gjykata, ndër të tjera, theksoi se (i) Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës është institucion i themeluar me nenin 101 të Kushtetutës; (ii) Kushtetuta i ka përcaktuar Këshillit statusin e institucionit të "*pavarur*" në ushtrimin e funksionit të tij kushtetues, përkatësisht, *"sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil";* (iii) bazuar në praktikën gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës, është përcaktuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës gëzon prerogativat e një "*tribunali*" në kuptim të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe se vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës janë *"përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme"*; dhe (iv) kontrolli i ligjshmërisë së vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës bëhet përmes inicimit të konflikt administrativ në gjykatën kompetente, rrjedhimisht, ato i nënshtrohen kontrollit të pushtetit gjyqësor.

Përkitazi me pavarësinë e anëtarëve Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, Gjykata theksoi se (i) pavarësia e ushtrimit të funksionit kushtetues të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për *"sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil"* nënkupton edhe pavarësinë e anëtarëve të tij në vendimmarrje; dhe (ii) për të njëjtin qëllim, vetë Kuvendi përmes Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka përcaktuar imunitetin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi "*lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit*", përkatësisht, për pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre si anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

Përkitazi me kompetencën e Kuvendit për të mbikëqyrur Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, Gjykata theksoi se (i) kompetenca e Kuvendit për të mbikëqyrë punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit është e përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës; dhe (ii) në rastin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, kjo kompetencë e Kuvendit është më tej e detajuar përmes Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës dhe përfshinë, ndër tjerash, edhe autorizimin e Kuvendit për ndërprerjen e mandatit të anëtarëve të Këshillit në rrethanat e përcaktuara përmes nenit 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) të këtij ligji. Megjithatë, Gjykata tutje theksoi se, ushtrimi i kompetencës për ndërprerje të mandatit, përjashton ndërprerjen e të njëjtit për shkak të *"vendimmarrjes"* së anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, sepse rrethana të tilla, (i) do të cenonin pavarësinë institucionale të Këshillit dhe anëtarëve të tij, siç është përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës; dhe (ii) do të ishin në kundërshtim me vetë përcaktimin e Kuvendit që anëtarët e Këshillit të gëzojnë imunitet nga shkarkimi për vendimmarrjen, siç është përcaktuar përmes dispozitave përkatëse të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar të Kuvendit, Gjykata rikujtoi se i njëjti është referuar në pikat 1.3 dhe 1.1 të paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. E para, përkatësisht pika 1.3 e nenit 15 e këtij ligji, përcakton mundësinë e ndërprerjes së mandatit "*në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij*". Megjithatë, Vendimi i kontestuar i Kuvendit, nuk përmban asnjë fakt e arsyetim se si pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës kolektivisht, mund të kenë ushtruar detyrat e anëtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës në papajtueshmëri me funksionin e tyre. Ndërsa, e dyta, përkatësisht pika 1.1 e nenit 15 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përcakton mundësinë e ndërprerjes së mandatit "*për shkelje të dispozitave të këtij ligji*". Në kontekst të kësaj të fundit, Vendimi i kontestuar i Kuvendit, thekson se "*është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK, për arsye se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes.*" Gjykata theksoi se Vendimi i kontestuar i Kuvendit, nuk i referohet asnjë fakti e arsyetimi në mbështetje të shkeljes së pretenduar të kësaj dispozite nga pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës kolektivisht, përpos vënies theks në "*vendimmarrjen*" e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Kjo për më tepër, rezulton nga fakti që Vendimit të kontestuar, i kishin paraprirë një sërë veprimesh dhe pyetjesh të Komisionit përkatës të Kuvendit drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës përkitazi me vendimmarrjen në raste konkrete.

Në këtë kontekst, Gjykata ritheksoi se (i) Kuvendi ka kompetencë kushtetuese të mbikëqyrë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, duke përfshirë mundësinë e ndërprerjes së mandatit të anëtarëve të tij në rastet e përcaktuara në Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; por se (ii) anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nuk mund të shkarkohen vetëm për shkak të "*vendimmarrjes*" së tyre sepse përkitazi me të njëjtën kanë pavarësi kushtetuese dhe ligjore, si dhe imunitet nga shkarkimi, siç është përcaktuar në vetë ligjin që ka miratuar Kuvendi. Për më

tepër që, bazuar në po të njëjtin ligj, ligjshmëria e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i nënshtrohet kontrollit të pushtetit gjyqësor dhe jo atij legjislativ.

Në këtë kontekst, Gjykata theksoi se Kuvendi duke shkarkuar (5) pesë anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës në mënyrë kolektive dhe pa shtjellimin e asnjë fakti e të bazuar në ligj, por vetëm me arsyetimin se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës *"nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes",* përkatësisht për shkak të vendimmarrjes së tyre në raste konkrete, për të cilën anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës gëzojnë pavarësi dhe imunitet nga shkarkimi dhe e cila vendimmarrje, për më tepër, i nënshtrohet kontrollit të pushtetit gjyqësor dhe jo atij legjislativ, ka tejkaluar kufijtë e kompetencës së mbikëqyrjes së punës së institucioneve publike, të përcaktuar me paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës, në cenim të garancive përkitazi me pavarësinë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës në ushtrimin e funksionit të tij të përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë kontekst, Gjykata theksoi që në ushtrimin e kompetencës kushtetuese për mbikëqyrjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, Kuvendi ka gjithashtu detyrimin që të ruajë pavarësinë e Këshillit, të cilën vetë ia ka atribuuar përmes miratimit të Kushtetutës dhe Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Për pasojë dhe përfundimisht, Gjykata konstatoi se Vendimi [nr. 08/V-029] i Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO127/21

parashtrues

Abelard Tahiri dhe 10 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-029, të Kuvendit të Republikës së Kosovës i 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga njëmbëdhjetë (11) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi), përkatësisht: Abelard Tahiri, Eliza Hoxha, Ganimete Musliu, Blerta Deliu Kodra, Hajdar Beqa, Fadil Nura, Ardian Kastrati, Elmi Reçica, Floretë Zejnullahu, Ariana Musliu Shoshi, Bekim Haxhiu (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës ose deputetët parashtrues).

2. Parashtruesit e kërkesës përfaqësohen në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), nga përfaqësuesi ligjor Faton Fetahu nga Prishtina.

Akti i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Vendimin [nr.08-V-029] të 30 qershorit 2021 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e

mëtejmë: Vendimi i kontestuar) për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Këshilli i Pavarur).

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, i cili sipas pretendimit të parashtruesve të kërkesës, nuk është në pajtueshmëri me nenin 101 [Shërbimi Civil] dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

5. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se bazuar në nenin 43 (Afati) të Ligjit, Vendimi i kontestuar i nënshtrohet efektit pezullues *ex-lege*. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës i referohen edhe (i) paragrafit 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton që përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme; dhe (ii) nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit, i cili përcakton që Gjykata, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës, mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

Baza juridike

6. Kërkesa është e bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji); si dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 7 korrik 2021, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatë, përmes së cilës, kontestuan Vendimin e Kuvendit për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur.

8. Më 14 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).

9. Më 16 korrik 2021, Gjykata për regjistrimin e kërkesës e njoftoi Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit dhe kërkoi që deri më 30 korrik 2021, të dorëzojnë në Gjykatë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me Vendimin e kontestuar.

10. Më 16 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës: Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryetari i Kuvendit), të cilit iu kërkua që një kopje e kërkesës t'u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit; Avokatin e Popullit dhe Këshillin e Pavarur. Gjykata i njoftoi palët e interesuara të cekura më lart se komentet e tyre, nëse kanë, t'i paraqesin në Gjykatë, brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor, përkatësisht deri më 30 korrik 2021, në adresën elektronike të Gjykatës ose me dorëzim personal.

11. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës edhe Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Presidentja) si dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryeministri).

12. Më 21 korrik 2021, Sekretari i Kuvendit dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë lidhur me Vendimin e kontestuar.

13. Më 30 korrik 2021, deputetja Doarsa Kica-Xhelili, deputete nga Grupi Parlamentar VETËVENDOSJE!, dorëzoi komentet në lidhje me kërkesën KO127/21.

14. Më 3 gusht 2021, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për pranimin e komenteve nga deputetja Kica-Xhelili, si dhe u ofroi mundësi që të ofrojnë komentet e tyre deri më 13 gusht 2021. Parashtruesit e kërkesës nuk dorëzuan komente shtesë.

15. Më 15 shtator 2021, Gjykata kërkoi nga Këshilli i Pavarur dokumente shtesë, përkatësisht (i) kopjen e dorëheqjes së z. Eshref Shabani nga pozita e Kryetarit të Këshillit të Pavarur; dhe (ii) çdo dokument tjetër relevant të 8 shtatorit 2021, përkatësisht të mbledhjes së jashtëzakonshme të këtij institucioni, lidhur me çështjen e dorëheqjes.

16. Më 17 shtator 2021, Këshilli i Pavarur bashkëngjiti (i) Vendimin e Këshillit të Pavarur nr.7/2021 të 8 qershorit 2021; (ii) Kopjen e Procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të Këshillit të 8 qershorit 2021, në të cilën e vetmja pikë e rendit të ditës ishte shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Këshillit të Pavarur për dorëheqje nga kjo pozitë; dhe (iii) Vendimin e Kuvendit për shkarkimin e 5 (pesë) anëtarëve të Këshillit të Pavarur.

17. Më 6 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri kërkoi shtyrjen e rastit për plotësime shtesë, ndërsa përkitazi me vlerësimin e masës së përkohshme, marrjen e informatave nga Kuvendi lidhur me veprimet e ndërmarra pas miratimit të Vendimit të kontestuar.

18. Më 12 tetor 2021, Gjykata kërkoi nga Kuvendi informata shtesë lidhur me veprimet e ndërmarra pas Vendimit të kontestuar.

19. Më 13 tetor 2021, Kuvendi ktheu përgjigje me informatat e kërkuara nga Gjykata, duke e informuar Gjykatën lidhur me shpalljen e konkurseve, përkatësisht Vendimin e Kryesisë së Kuvendit për shpalljen e konkursit për pesë (5) anëtarë të Këshillit nga 23 gushti 2021; dhe Vendimin e Kryesisë së Kuvendit për rishpalljen e konkursit për pesë (5) anëtarë të Këshillit nga komuniteti shqiptar dhe për dy (2) anëtarë nga radhët e komuniteteve joshumicë nga 6 tetori 2021.

20. Më 20 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi propozimin e Gjyqtarit raportues përkitazi me vendimin për masën e përkohshme dhe njëzëri kërkoi plotësimin e mëtejmë të këtij propozimi.

21. Më 21 tetor 2021, Gjyqtari raportues i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme. Po të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri vendosi masën e përkohshme përkitazi me Vendimin e kontestuar deri më 15 dhjetor 2021.

22. Më 24 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri kërkoi shtyrjen e rastit për plotësime shtesë.

23. Më 9 dhjetor 2021, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata votoi dhe njëzëri vendosi se Vendimi [nr. 08-V-029] i 30 qershorit 2021 i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

24. Më 8 tetor 2020, pas tri raundeve të votimit të fshehtë, Kuvendi përmes Vendimit [Nr.07-V-063], vendosi për zgjedhjen e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur. Ky vendim ishte bazuar në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, nenet 8 (Përbërja e Këshillit), 10 (Procedura për emërimin e anëtarëve të Këshillit) dhe 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji për KPMSHCK-në), si dhe nenet 51 dhe 84 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

25. Më 31 mars 2021, bazuar në paragrafin 1 të nenit 28 (Raporti vjetor i Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-së, Këshilli i Pavarur i paraqiti Kuvendit Raportin Vjetor të Punës së tij për vitin 2020.

26. Më 28 prill 2021, Kryetari i Kuvendit: (i) ua përcolli Raportin Vjetor të Këshillit të Pavarur deputetëve të Kuvendit, si dhe (ii) ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal (në tekstin në vijim: Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike) dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, që t'a shqyrtojnë këtë raport dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet respektive me rekomandime.

27. Më 1 qershor 2021, u mbajt mbledhja e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, ku me gjashtë (6) vota kundër, u votua kundër miratimit të Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur për vitin 2020.

28. Më 2 dhe 3 qershor 2021, Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike përmes Zyrës Koordinuese të Komisionit i kërkoi Këshillit të Pavarur informatat si në vijim: (i) të dhënat për të gjitha lëndët që kanë qenë në pritje para se Këshilli i Pavarur të vendoste për lëndën që ishte diskutuar në Komision (rasti i N.K.-së), përfshirë por pa u kufizuar në evidentimin e numrit të lëndëve paraprake para se të vendoset për këtë rast; dhe (ii) numrin e saktë të të gjitha lëndëve në pritje, datat e sakta të parashtrimit të secilës ankesë/kërkesë/parashtresë që ka qenë në pritje dhe është dorëzuar para lëndës së N.K.-së, e që megjithatë nuk është trajtuar para kësaj lënde. Po ashtu, ky Komision kërkoi edhe informatat si në vijim: (i) a janë trajtuar të gjitha rastet që u evidentuan si në pritje në pyetjen paraprake, brenda afatit dyzet e pesë (45) ditësh; dhe (ii) të konfirmohet në qoftë se të gjitha këtyre rasteve nuk ka pasur nevojë t'i jepet kohë shtesë për trajtim, por ka mjaftuar afati në fjalë apo ajo që ka mbetur nga ky afat me rastin e bartjes. Me rastin e dërgimit të këtij

sqarimi, Zyra Koordinuese e Komisionit kërkoi që (i) t'i dërgohen edhe data e vendimmarrjes për rastet që u identifikuan si në pritje në pyetjen paraprake; dhe (ii) të bashkëlidhin dosjen e plotë të rastit të N.K.-së.

29. Më 7 qershor 2021, Kryetari i Këshillit, Eshref Shabani, ktheu përgjigje në kërkesën e lartcekur duke theksuar që: (i) Këshilli i Pavarur është i paparë në bazë të paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës, ku përcaktohet se "*një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës*"; (ii) ofroi informata lidhur me mënyrën e ndarjes së lëndëve tek anëtarët e Këshillit të Pavarur, si dhe vendosjen e rasteve në kolegje të përbëra nga tre anëtarë që ishin vendosur me Vendimin e KPMSHCK-së [Nr.2] të 14 tetorit 2020, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 3 të nenit 16 (Shqyrtimi i ankesave) të Ligjit për KPMSHCK-në; dhe (iii) ofroi informata lidhur me lëndën e ankuesit N.K., ku theksoi që ankesa e këtij të fundit ishte pranuar më 7 shkurt 2019 dhe ishte ankesa e 77-të e pranuar në vitin 2019. Më tej, sqaroi si kjo ankesë i ishte ndarë atij dhe se lënda është trajtuar bazuar në radhën e rasteve të vitit 2019 që i ishin caktuar, prandaj nuk i ishte dhënë ndonjë prioritet në trajtim të rastit, duke sqaruar gjithashtu se si është propozuar zgjatja e afatit të vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë, bazuar në paragrafin 2 të nenit 17 (Afati i vendimmarrjes në Këshill) të Ligjit për KPMSHCK-në.

30. Më 8 qershor 2021, Këshilli i Pavarur mbajti mbledhjen e jashtëzakonshme dhe nxori Vendimin nr.7/2021, përmes së cilit theksohet se z. Eshref Shabani ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e kryetarit të Këshillit të Pavarur dhe përmes së cilës vendoset që z. Arben Mehmeti kryeson Këshillin deri në zgjedhjen e kryetarit të ri. Sipas komenteve të Këshillit të Pavarur të 15 shtatorit 2021, procesverbali ka mbetur i pa miratuar nga Këshilli sepse anëtarët ishin shkarkuar. Gjykata, vëren se bazuar në shkresat e lëndës, z. Shabani kishte dhënë dorëheqje nga pozita e Kryetarit të Këshillit të Pavarur, e jo nga pozita e anëtarit.

31. Më 10 qershor 2021, Këshilli i Pavarur njoftoi Komisionin e Kuvendit për Administratë Publike se: (i) Eshref Shabani kishte dhënë dorëheqje nga pozita e Kryetarit të Këshillit; dhe se (ii) në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit të Pavarur të 8 qershorit 2021, u aprovua dorëheqja e tij dhe në bazë të dispozitave të Rregullores së Punës 01/2018 për KPMSHCK-në, u vendos që deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri, Kryesues të jetë Arben Mehmeti.

32. Më 15 qershor 2021, Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike nxori Rekomandimin [08/314/Ra-11] që: *"1.Të mos miratohet Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2020,"* me arsyetimin që Raporti nuk i përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon mos miratimin e tij.

33. Në të njëjtën ditë, Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike, me gjashtë (6) vota *"për"* dhe katër (4) *"kundër"* përmes Rekomandimit [08/315/Do-213], i rekomandoi Kuvendit që të shkarkojë pesë (5) anëtarët e Këshillit të Pavarur. Në arsyetimin e rekomandimit u theksua që inicimi i procedurës së shkarkimit u bë sipas paragrafit 1, pikat 1 dhe 3 të nenit 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në si në vijim, përkatësisht (i) për shkelje të dispozitave të Ligjit për KPMSHCK-në; dhe (ii) në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij. Për më tepër, në rekomandimin përkatës u theksua se: *"është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK, për arsyet se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes"*.

34. Më 17 qershor 2021, Këshilli i Pavarur i drejtohet Kuvendit përmes parashtresës ku shpreh shqetësimin e anëtarëve të Këshillit lidhur me iniciativën për shkarkim të anëtarëve të KPMSHCK-së në arsyetimin që: (i) Këshilli i Pavarur është institucion i pavarur i përcaktuar në nenin 101 të Kushtetutës; (ii) anëtarët e Këshillit të Pavarur lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi; (iii) theksojnë që Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike nuk ka ekspertizë dhe njohuri të nevojshme që të shqyrtojë lëndë konkrete siç kanë bërë anëtarët e këtij Komisioni; dhe (iv) në përputhje me Ligjin nr.03/L-176 për Hetim Parlamentar, të iniciohet themelimi i Komisionit Hetimor Parlamentar dhe ky Komision të merret me analizën e hollësishme të vlerësimit të punës së anëtarëve të Këshillit të Pavarur.

35. Më 30 qershor 2021, në seancën plenare të Kuvendit u votua lidhur me rekomandimin e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur. Rezultati i votimit ishte si në vijim: gjashtëdhjetë e dy (62) vota "*për*" shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur, tre (3) vota "*kundër*" dhe njëmbëdhjetë (11) vota "*abstenime*". Rrjedhimisht, Kuvendi përmes Vendimit [Nr.08-V-029], votoi shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të KPMSHCK-së.

36. Me 19 korrik 2021, Kryesia e Kuvendit përmes Vendimit [nr.08-V-049] vendosi që nga 23 gushti 2021, të shpallet konkursi për pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur, nga komuniteti shqiptar. Përderisa, brenda afatit prej njëzet e një (21) ditësh, deri me 13 shtator 2021, nuk kishin aplikuar kandidatë të mjaftueshëm, Kryesia e Kuvendit, me 29 shtator 2021, përmes Vendimit [Nr.08-V-065], rishpalli konkursin publik për pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur nga komuniteti shqiptar dhe për dy (2) anëtarë nga radhët e komuniteteve joshumicë. Konkursi u shpall më 6 tetor 2021 dhe mbeti i hapur deri më 25 tetor 2021.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

37. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Vendimi i kontestuar i Kuvendit në aspektin përmbajtësor dhe procedural, është në kundërshtim me nenin 101 [Shërbimi Civil] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.

(i) Pretendimet lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

38. Parashtruesit e kërkesës, theksojnë se bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës KO73/16, dhe veçanërisht paragrafët 43 dhe 49 të tij, Vendimi i kontestuar ngre çështje kushtetuese sepse hyn në sfondin e normave të përcaktuara përmes neneve 101 [Shërbimi Civil] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.

39. Parashtruesit e kërkesës, argumentojnë se Gjykata Kushtetuese duhet të bëjë interpretimin e normave kushtetuese kurdo që një çështje i adresohet asaj nga institucionet e mandatuara për referim dhe në rastin konkret, sipas parashtruesve të kërkesës, në mënyrë që të mbrohet sistemi i shërbimit civil, i përfaqësuar nga Këshilli *"anëtarëve të të cilit sistem, në mënyrë indirekte përmes vendimit kontestues, u është cenuar siguria juridike, të cilën u ka ofruar Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka përgjegjësi të pavarur nga Qeveria për t'i mbrojtur parimet e shërbimit publik dhe të drejtat e shërbyesve (nënpunësve) të këtij sistemi"*. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë që Vendimi i kontestuar të shqyrtohet në merita.

(ii) Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 101 dhe 142 të Kushtetutës

40. Parashtruesit e kërkesës fillimisht theksojnë se paragrafi 2 i nenit 101 i Kushtetutës e vendos Këshillin e Pavarur në funksionin e një institucioni të pavarur që duhet të garantojë që standardet e meritës,

profesionalizmit, neutralitetit ndaj politikës dhe të karakterit civil të shërbimit civil të gjejnë shprehje në punën dhe veprimtarinë e shërbimit civil të shtetit. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Kuvendi, Qeveria dhe organet tjera politike zhvishen nga kompetencat që të ndërhyjnë në ruajtjen e integritetit profesional të shërbimit civil, sepse kjo kompetencë i është bartur një institucioni të pavarur.

41. Më tej, parashtruesit e kërkesës i referohen edhe disa Aktgjykimeve të Gjykatës, duke argumentuar se (i) Vendimet e Këshillit të Pavarur janë përfundimtare dhe, si të tilla, paraqesin titull të vlefshëm ekzekutiv; dhe (ii) procedurat para këtij organi gjysmë gjyqësor (*kuazi-gjyqësor*) duhet të respektojnë rregullat mbi gjykimin e drejtë dhe të paanshëm, duke përfshirë këtu edhe procedurën e ekzekutimit te vendimeve te Këshillit të Pavarur.

42. Parashtruesit e kërkesës i referohen dhe nenit 142 të Kushtetutës, duke theksuar se i njëjti rregullon formën dhe mënyrat e themelimit të Agjencive të Pavarura dhe përcakton katër parime bazë që duhet të shoqërojnë themelimin dhe funksionimin e Agjencive të Pavarura, përkatësisht theksojnë argumentet si në vijim: (i) Kuvendi i Kosovës është autoriteti kushtetues i cili mban tagrin e themelimit të Agjencive të Pavarura, e që për themelimin e tyre, neni 142 i Kushtetutës përcakton që Kuvendi duhet të nxjerrë ligjet përkatëse, që rregullojnë, ndër të tjera, funksionimin, dhe fushëveprimin ligjor të tyre; (ii) Kushtetuta përcakton që Agjencive të Pavarura duhet t'u garantohet që ushtrimi i funksionit të tyre ligjor të realizohet pa ndikim dhe në mënyrë të pavarur nga çdo udhëzim apo ndërhyrje e organeve tjera shtetërore, përfshirë organin që e ka themeluar; (iii) për garantimin e pavarësisë së Agjencive të Pavarura, neni 142 i Kushtetutës përcakton që ato duhet të posedojnë buxhetin e tyre të veçantë, dhe të administrojnë me këtë të fundit në mënyrë të pavarur; dhe (iv) parimi kushtetues i cili duhet të shoqërojë themelimin e Agjencive të Pavarura, lidhet me garancionin kushtetues që organet tjera shtetërore të ruajnë pavarësinë, të bashkëpunojnë dhe t'u përgjigjen kërkesave të Agjencive të Pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre kushtetuese dhe ligjore.

43. Parashtruesit e kërkesës i referohen dhe Ligjit për KPMSHCK-në, duke theksuar se: (i) përmes Vendimit të kontestuar në seancë plenare me shumicë votash u vendos për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur, rrjedhimisht ndërprerjen e mandatit të tyre kushtetues; (ii) janë shkarkuar në mënyrë kolektive, përkundër faktit të pakontestueshëm që anëtarët e këtij institucioni, zgjedhen individualisht në një procedurë të përcaktuar qartësisht në Kuvend, e

që sipas parashtruesve të kërkesës, me këtë rast, ka pasur shkelje të procedurës që është ndjekur përkitazi me shkarkimin e tyre.

44. Më tej, parashtruesit e kërkesës i referohen nenit 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në, duke theksuar se Vendimi për shkarkimin (ndërprerjen) e mandatit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur është kundërkushtetues sepse me rastin e shkarkimit nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet e këtij neni. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i referohen arsyetimit të dhënë përmes Vendimin e kontestuar për *"për shkelje të dispozitave të ligjit për Këshillin; në rast të kryerjes së detyrave në papajtueshmëri të funksionit të tij"* dhe arsyetimit në Rekomandim ku thuhet *"(...) është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK-në, për arsye se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes"*. Për këto arsye, në esencë parashtruesit e kërkesës theksojnë se fjala "*shkelje të dispozitave të ligjit për Këshillin",* konsumon të gjitha, dhe në fakt nuk janë përmbushur arsyet e nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në.

45. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pohojnë se nuk ekziston asnjë fakt i paraqitur në rekomandimin e Komisionit Parlamentar për Administratë Publike: (i) që dëshmon se anëtarët e Këshillit të Pavarur kanë shkelur Ligjin për KPMSHCK-në; dhe (ii) që dëshmon se anëtarët e shkarkuar të Këshillit të Pavarur kanë kryer veprimtari, që krijon konflikt të interesit, siç përcaktohet me nenin 15 të Ligjit për KPMSHCK-në; (iii) që dëshmon se anëtarët e shkarkuar të Këshillit të Pavarur kanë kryer detyrat në papajtueshmëri me funksionin e tyre, siç përcaktohet me nenin 15 të Ligjit për KPMSHCK-në; dhe (iv) që dëshmon se anëtarët e shkarkuar të Këshillit të Pavarur kanë munguar pa arsye në punë mbi pesë (5) ditë për arsyet që nuk parashihen me ligj, siç përcaktohet nenin 15 të Ligjit për KPMSHCK-në.

46. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se anëtarët e Këshillit të Pavarur dhe vetë Këshilli i Pavarur si organ i pavarur kushtetues i janë nënshtruar presionit dhe ndërhyrjeve nga ana e Komisionit Parlamentar për Administratë Publike e që sipas parashtruesve të kërkesës dëshmon tendencën për të ndërhyrë në pavarësinë e këtij institucioni. Parashtruesit e kërkesës i referohen edhe një e-maili zyrtar të dërguar me 2 qershor 2021, në adresën zyrtare të Këshillit të Pavarur, përmes të cilit janë kërkuar informacione shtesë për një rast konkret që ka qenë duke u zgjidhur pranë Këshillit të Pavarur, e që një ditë më vonë është kërkuar dosja e plotë e rastit përkatës.

47. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se edhe sipas Aktgjykimit në rastin KO171/18, neni vendimtar në rrethanat e rastit konkret, u vlerësua në tërësi në pajtim me Kushtetutën, përkatësisht paragrafi 3 i nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-së i cili thekson që: *"3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi."*

48. Duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO171/18 e veçanërisht paragrafit 247, parashtruesit e kërkesës vënë theks edhe në paragrafin 3 të nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në, duke theksuar çështjen e imunitetit dhe duke cituar se *"[...] Qëllimi i imunitetit është që anëtarët e Këshillit të jenë të lirë të ushtrojnë funksionin e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve te tyre [...]"*. Parashtruesit e kërkesës theksojnë që ky Aktgjykim tashmë ka statusin e normës juridike. Për më tepër, si shembull krahasues, citojnë dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë 29/2011, të 7 prillit 2011, duke argumentuar se shërbyesit civil nuk mund të shkarkohen nga detyra pa ofruar një arsyetim të detajuar lidhur me një gjë të tillë.

49. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të (i) shpallë kërkesën e pranueshme; dhe (ii) të shpallë Vendimin e kontestuar në kundërshtim me Kushtetutën, dhe për pasojë, të njëjtin t'a shpallë të pavlefshëm.

(iii) Kërkesa për masë të përkohshme

50. Parashtruesit e kërkesës sa i përket masës së përkohshme, kërkojnë që Gjykata të pranojë nenin 43 të Ligjit, duke iu referuar kështu efektit pezullues *ex-lege* të zbatimit të ligjit apo vendimit të Kuvendit. Parashtruesit e kërkesës i referohen edhe paragrafit 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton që përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu vënë theks në nenin 27 (Masat e Përkohshme) të Ligjit.

51. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës: (i) kërkojnë nga Gjykata të informojë palët e përfshira që Vendimi i kontestuar pezullohet *ex-lege* dhe nuk mund të zbatohet deri në vendimin final të Gjykatës; dhe (ii) vlerësojnë se nuk është e nevojshme të kërkojnë shprehimisht

pezullimin e zbatimit të aktit të kontestuar, përderisa i njëjti sipas ligjit do të duhej t'i nënshtrohej efektit pezullues në zbatim, meqë është kontestuar pranë kësaj Gjykate, në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës.

(iv) Kërkesa për Seancë Dëgjimore

52. Parashtruesit e kërkesën lidhur me shqyrtimin e rastit, bazuar në nenin 42 të Rregullores së Punës, kërkojnë mbajtjen e seancës dëgjimore lidhur me kontestimin e Vendimit për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të KPMSHCK-së.

53. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës theksojnë se është në interes publik që të mbahet kjo seancë dëgjimore publike, për shkak se përmbajtja e Vendimit të kontestuar cenon rendin kushtetues dhe dispozitat konkrete kushtetuese që lidhen me sigurinë juridike të punonjësve të administratës shtetërore dhe publike dhe pavarësinë e një institucioni të pavarur të nivelit kushtetues.

Përmbledhja e Komenteve të Deputetes Doarsa Kica Xhelili

54. Deputetja Kica-Xhelili në komentet e paraqitura lidhur me kërkesën KO127/21, thekson që neni 101 i Kushtetutës për sa i përket lidhshmërisë me Këshillin e Pavarur, përcakton vetëm rolin e përgjithshëm të Këshillit të Pavarur në kontekst të rregullimit të shërbimit civil në Kosovë, por nuk flet për përbërjen apo mënyrën e zgjedhjes dhe shkarkimit të anëtarëve të tij.

55. Gjithashtu, deputetja Kica-Xhelili thekson që edhe neni 142 i Kushtetutës, flet në mënyrë të përgjithësuar për Agjencitë e Pavarura. Referimi në faktin që këto agjenci kryejnë funksionet e tyre *në "mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës*", sipas komenteve, nuk zgjeron fushëveprimin e këtij neni në interpretimin e diskrecionit të Kuvendit në vlerësimin e kushteve ligjore për emërim dhe shkarkim të anëtarëve të Këshillit të Pavarur. Prandaj, sipas deputetes Kica-Xhelili është argument plotësisht i devijuar të thuhet se ushtrimi i funksionit të rolit diskrecional të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, karshi interpretimit ligjor të dispozitave të Ligjit për KPMSHCK-në, bie në ndonjë mënyrë në spektrin e të drejtave kushtetuese. Përfundimisht, ajo vë theksin se të referuarit në nenet 101 dhe 142 të Kushtetutës, nuk përkon me dispozita të cilat përcaktojnë kriteret e shkarkimit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur apo Agjencive të Pavarura.

56. Në vijim, deputetja Kica-Xhelili thekson që Gjykata Kushtetuese merret me aspektin kundërkushtetues të pretendimeve të palës parashtruese, dhe jo me kundërligjshmërinë që është detyrë e gjykatave të rregullta. Përkatësisht, sipas deputetes, ligjshmëria e një vendimi, përfshirë këtu e një vendimi administrativ të një organi publik, është kompetencë lëndore e gjykatave të rregullta. Pra, ajo thekson se në rast se anëtarët e Këshillit të Pavarur do ta vlerësonin Vendimin e Kuvendit si të kundërligjshëm, do të duhej t'i drejtoheshin gjykatave të rregullta për të konstatuar kundërligjshmërinë e pretenduar të Vendimit. Ndërkohë, deputetët e Kuvendit, nuk kanë legjitimitet t'i drejtohen gjykatave të rregullta në emër të tanimë ish-anëtarëve të KPMSHCK-së, përmes konfliktit administrativ.

57. Në vijim, deputetja i referohet edhe rastit të Gjykatës KI79/19, Aktvendim për Papranueshmëri i 10 gushtit 2020, ku në paragrafin 56, theksohet si në vijim: "*(...) Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). (...) Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, Garcia Ruiz kundër Spanjës, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KI06/17, parashtrues L. G. dhe pesë të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues Riza Dembogaj, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 qershorit 2018, paragrafi 57).*"

58. Përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë, deputetja gjithashtu thekson që Gjykata ka për detyrë interpretimin përfundimtar të dispozitave të Kushtetutës. Ndërsa, juridiksioni që bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës nënkupton vlerësimin e kushtetutshmërisë së çfarëdo ligji apo vendimi. Sipas pretendimit, vendimet e Kuvendit mund të jenë objekt i vlerësimit kushtetues në aspekt procedural dhe përmbajtësor, por vetëm në kuptim të kushtetutshmërisë.

59. Për më tepër, sipas komenteve përkatëse, parashtruesit e kërkesës nuk e kanë të qartë ose qëllimisht ngatërrojnë procesin ligjvënës dhe funksionin mbikëqyrës të Kuvendit, sepse qëllimisht nuk precizojnë (saktësojnë kërkesën) nëse e kontestojnë procedurën apo kontestojnë përmbajtjen e aktit. Sipas saj, në këtë mënyrë shmangin

argumentimin, ngase për t'u vlerësuar një akt i Kuvendit në aspektin kushtetues do të duhej që Kushtetuta të përcaktojë shprehimisht të paktën se cila është procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Pavarur, madje edhe procedurën e shkarkimit. Në rastin konkret, përbërja, funksionimi, përgjegjësitë, mënyra e zgjedhjes dhe mënyra e shkarkimit janë përcaktuar me ligj të veçantë. Kësisoj, Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur, edhe pse akt i një organi publik, nuk përbën objekt të vlerësimit të kushtetutshmërisë.

60. Përfundimisht, deputetja thekson që kërkesa e parashtruesve të kërkesës nuk ka të bëjë me një të drejtë kushtetuese dhe për rrjedhojë nuk mund të jetë objekt vlerësimi në Gjykatën Kushtetuese.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 101
[Shërbimi Civil]

1.Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.
2.Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës.

[...]

Neni 142
[Agjencitë e Pavarura]

1.Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës.
2.Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj.
3.Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të

pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj.

LIGJI NR. 06/L-048 PËR KËSHILLIN E PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Neni 4
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

[...]
2. Këshilli për punën e tij i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës, së paku njëherë në vit, dhe sa herë që i kërkohet nga Kuvendi.

Neni 6
Funksionet e Këshillit

1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:
1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;
1.2. mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;(shfuqizuar me Aktgjykimin e Gjykatës KO171/18)
1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civilë

Neni 11
Mandati i anëtarëve të Këshillit

1. Anëtarët e Këshillit emërohen për mandat shtatë (7) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes për mandat tjetër.

2. Anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marr pjesë në aktivitete politike.

3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi.

Neni 12
Detyrat e anëtarëve të Këshillit

1. Anëtarët e Këshillit kanë për detyrë që të ushtrojnë funksionin e anëtarit në mënyrë të paanshme dhe të vendosin në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.

2. Anëtarët e Këshillit kanë për detyrë të ruajnë autoritetin dhe imazhin e Këshillit.

3. Secili anëtar ka për detyrë të marr pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Këshillit, si dhe të kryej punët e tjera të caktuara me ligj, me rregulloren e punës dhe aktet tjera nënligjore të Këshillit.

Neni 15
Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit

1. Kuvendi i Kosovës me shumicë të votave mund të shkarkojë anëtarin e Këshillit për shkak të arsyeve në vijim:

1.1. për shkelje të dispozitave të këtij ligji;

1.2. kur kryen veprimtari, që krijon konflikt të interesit dhe përkundër paralajmërimit nga organi kompetent nuk e eliminon konfliktin e interesit sipas ligjit përkatës;

1.3. në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij;

1.4. mungon pa arsye në punë mbi pesë (5) ditë për arsyet që nuk parashihen me ligj.

2. Propozimin për shkarkim të anëtarit të Këshillit, kanë të drejtë ta bëjnë:

2.1. shumica e anëtarëve të Këshillit;

2.2. Komisioni përkatës i Kuvendit për administratë publike.

Neni 16
Shqyrtimi i ankesave

3. Në emër të Këshillit, ankesat i shqyrton dhe i vendos Kolegji i përbërë nga tre (3) anëtarë, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit.

Neni 17
Afati i vendimmarrjes në Këshill

1. Këshilli brenda afatit prej dyzetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, nxjerr vendim duke e arsyetuar bazën ligjore dhe faktike të vendimmarrjes.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në rastet kur natyra e lëndës është specifike, Kryetari i Këshillit ka të drejtë të shtyjë afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Pranueshmëria e kërkesës

61. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

62. Fillimisht, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*

63. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur".*

64. Fillimisht, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit të kontestuar në lidhje me (i) procedurën e ndjekur dhe (ii) përmbajtjen e tij, siç është përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.

65. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kërkesa është paraqitur nga njëmbëdhjetë (11) deputetë të Kuvendit, në pajtueshmëri me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar.

66. Në vijim, Gjykata merr parasysh nenin 42 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

> *"1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6, të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:*
>
> > *1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
> >
> > *1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
> >
> > *1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti".*

67. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 74 [Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës, që parasheh:

> *"[...]*
>
> *(2) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:*
>
> > *(g) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose të një vendimi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;*
> >
> > *(h) dispozitat e Kushtetutës ose të aktit tjetër ose legjislacionit relevant për këtë kërkesë; dhe*
> >
> > *(i) provat mbi të cilat mbështetet kontesti.*
>
> *(3) Parashtruesit i bashkëngjisin kërkesës një kopje të ligjit të kontestuar ose vendimit të miratuar nga Kuvendi, regjistrin dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën dhe autorizimin e personit që i përfaqëson ata para Gjykatës".*

68. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës: (i) shënuan emrat e deputetëve me nënshkrime si dhe paraqitën autorizimin për personin që i përfaqëson para Gjykatës; (ii) specifikuan vendimin që kontestojnë dhe dorëzuan kopjen e tij; (iii) iu referuan dispozitave relevante kushtetuese për të cilat ata pretendojnë se Vendimi i kontestuar nuk është në pajtueshmëri; dhe (iv) paraqitën provat dhe dëshmitë e tyre në mbështetje të pretendimeve përkatëse. Andaj, Gjykata konsideron se kriteret e përcaktuara me nenin 42 të Ligjit dhe të specifikuara më tej me rregullin 74 të Rregullores së punës janë plotësuar.

69. Gjykata më tej vlerëson nëse kërkesa është paraqitur në afatin e përcaktuar prej *"8 (tetë) ditësh nga data e miratimit"*, ashtu siç përcaktohet në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Vendimi i kontestuar është miratuar më 30 qershor 2021, ndërsa kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 7 korrik 2021. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa u parashtrua brenda afatit kohor të përcaktuar me Kushtetutë.

70. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës. Gjykata gjithashtu konsideron se kërkesa ngre çështje të rëndësishme kushtetuese lidhur me pavarësinë institucionale të Këshillit të Pavarur, si institucion i pavarur sipas Kushtetutës, i cili siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin civil. Për pasojë, kërkesa duhet të shpallet e pranueshme dhe të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

71. Gjykata fillimisht rithekson që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me Vendimin [nr. 08-V-029] e 30 qershorit 2021 të Kuvendit, përmes të cilit, bazuar në Rekomandimin e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, janë shkarkuar kolektivisht pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur.

72. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Vendimi i kontestuar i Kuvendit në aspektin përmbajtësor dhe procedural është në kundërshtim me nenin 101 [Shërbimi Civil] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.

73. Në lidhje me kërkesën e tyre, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës, në thelb, lidhur me pretendimet e tyre kushtetuese i

referohen: (i) nenit 101 të Kushtetutës, duke theksuar se i njëjti e vendos Këshillin e Pavarur në funksionin e një institucioni të pavarur, e që Kuvendi, Qeveria dhe organet tjera politike zhvishen nga kompetencat që të ndërhyjnë në ruajtjen e integritetit profesional dhe civil të shërbimit civil; (ii) nenit 142 të Kushtetutës, duke theksuar se i njëjti rregullon formën dhe mënyrat e themelimit të Agjencive të Pavarura, në esencë duke e kategorizuar Këshillin e Pavarur në këtë pjesë, gjithashtu duke theksuar se agjencitë ushtrojnë funksionet e tyre ligjore pa ndikim dhe në mënyrë të pavarur nga çdo udhëzim apo ndërhyrje e organeve tjera shtetërore, përfshirë organin që e ka themeluar.

74. Më tej, Gjykata rikujton se në elaborimin e shkeljeve të pretenduara kushtetuese si më lart, parashtruesit e kërkesës: (i) i referohen Ligjit për KPMSHCK-në duke theksuar se me këtë rast ka pasur shkelje të procedurës që është ndjekur për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur sepse të njëjtit janë shkarkuar në mënyrë kolektive edhe pse zgjedhën individualisht në pozitën e tyre; (ii) i referohen nenit 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në, duke theksuar se Vendimi për shkarkimin/ndërprerjen e mandatit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur është kundër-kushtetues sepse me rastin e shkarkimit nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet e këtij neni dhe se nuk ekziston asnjë fakt i paraqitur në rekomandim që pretendon se anëtarët e Këshillit të Pavarur e kanë shkelur ligjin; (iii) pohojnë se anëtarët e Këshillit dhe vetë Këshilli si organi i pavarur kushtetues i janë nënshtruar presionit dhe ndërhyrjeve nga ana e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike e që sipas parashtruesve të kërkesës dëshmon tendencën për të ndërhyrë në pavarësinë e këtij institucioni; dhe (iv) duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO171/18 e veçanërisht paragrafit 247 të tij, dhe paragrafit 3 të nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në, theksojnë çështjen e imunitetit nga shkarkimi për vendimmarrje.

75. Marrë parasysh pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe rrethanat që ngërthen rasti, Gjykata thekson se është e rëndësishme që së pari të elaborohet statusi i Këshillit të Pavarur dhe pavarësia e tij si institucion bazuar në Kushtetutë, ligjet e aplikueshme dhe në Aktgjykimet e Gjykatës; si dhe kompetenca e Kuvendit për të mbikëqyrë punën e Këshillit të Pavarur, duke kaluar më pas në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar për shkarkimit e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur. Rrjedhimisht, Gjykata në vijim do të shtjellojë parimet e përgjithshme lidhur me (i) aplikueshmërinë e nenit 142 të Kushtetutës; (ii) statusin dhe pavarësinë e Këshillit të Pavarur dhe anëtarëve të tij, bazuar në

paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës; për të vazhduar më pas me (iii) kompetencën e Kuvendit për mbikëqyrjen e Këshillit të Pavarur; dhe në fund do të aplikojë këto parime në (iv) vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar.

I. Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës

76. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesit e kërkesës, mes tjerash, i referohen nenit 142 të Kushtetutës, për të mbështetur argumentet e tyre, lidhur me cenimin e pavarësisë së Këshillit të Pavarur.

77. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton Aktgjykimin e saj KO171/18, në të cilin kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e Ligjit për KPMSHCK-në, ligj ky i cili rregullon funksionet, kompetencat, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Pavarur (shih, rastin e Gjykatës KO171/18, me parashtrues *Avokati i Popullit,* Vlerësim i Kushtetutshmërisë së neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, Aktgjykim i 25 prillit 2019). Përmes këtij Aktgjykimi, Gjykata, ndër tjerash, theksoi se Kapitulli XII [Institucionet e Pavarura] i Kushtetutës rregullon në mënyrë të veçantë institucionet e pavarura si në vijim: (i) Avokatin e Popullit (nenet 132-135 të Kushtetutës); (ii) Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës (nenet 136-138 të Kushtetutës); (iii) Komisionin Qendror i Zgjedhjeve (neni 139 i Kushtetutës); (iv) Bankën Qendrore të Kosovës (neni 140 i Kushtetutës); dhe (v) Komisionin e Pavarur të Medieve (neni 141 i Kushtetutës). Po ashtu, neni 142 [Agjencitë e Pavarura] i Kushtetutës, në kuadër të të njëjtit kapitull, përcakton mundësinë e krijimit të Agjencive të Pavarura nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Sipas këtij neni, këto agjenci, (i) funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës; dhe (ii) secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligjin përkatës.

78. Përveç kësaj, Kushtetuta ka themeluar edhe disa institucione tjera, ndër të tjera, Gjykatën Kushtetuese në kapitullin VIII të saj, si dhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil në nenin 101 të saj. Në Aktgjykimin e saj në rastin KO171/18, Gjykata konstatoi që Këshilli i Pavarur nuk mund të kategorizohet si institucion i pavarur

kushtetues sipas Kapitullit XII të Kushtetutës dhe as si agjenci e pavarur në bazë të nenit 142 të Kushtetutës, për shkak se (i) Kushtetuta, në mënyrë shprehimore, i ka përcaktuar në Kapitullin XII të saj, institucionet e pavarura kushtetuese, duke përcaktuar edhe rolin dhe statusin e tyre; si dhe (ii) në Kapitullin XII, neni 142 i Kushtetutës, ka krijuar bazën kushtetuese për themelimin e agjencive të pavarura, duke përcaktuar se janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse e të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre (shih, rastin KO171/18, cituar më lartë, paragrafët 155-159).

79. Gjykata vëren se përderisa, themelimi i agjencive të pavarura në bazë të nenit 142 të Kushtetutës, është kompetencë e Kuvendit, dhe i cili përmes ligjeve përkatëse rregullon edhe themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre, Kuvendi nuk ka të njëjtën kompetencë përkitazi me institucionet e themeluara përmes dispozitave kushtetuese, duke përfshirë Këshillin e Pavarur, sepse themelimi, funksionimi dhe kompetencat e tij, për aq sa janë të rregulluara me Kushtetutë, nuk mund të ndryshohen nga Kuvendi, përpos përmes amendamenteve kushtetuese.

80. Gjykata marrë parasysh të lartcekurat, rithekson se për dallim nga Agjencitë e Pavarura dhe të cilat bazuar në nenin 142 të Kushtetutës, themelohen nga Kuvendi, Këshilli i Pavarur është institucion i cili është i themeluar përmes nenit 101 të Kushtetutës, dhe si i tillë pavarësia institucionale, e cila i është atribuuar, tejkalon atë të garantuar për Agjencitë e Pavarura përmes nenit 142 të Kushtetutës. Për pasojë, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës në kuadër të fushëveprimit të nenit 101 të Kushtetutës.

II. Sa i përket statusit dhe pavarësisë së Këshillit të Pavarur dhe anëtarëve të tij, bazuar në paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës

81. Gjykata rikujton se paragrafi 2 i nenit 101 përcakton se *"Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës."*

82. Duke u bazuar në këtë normë kushtetuese, Gjykata fillimisht do të trajtojë pavarësinë e Këshillit të Pavarur bazuar në (i) parimet e përgjithshme në lidhje me Këshillin sipas Kushtetutës, Ligjit për KPMSHCK-në dhe praktikës së Gjykatës; dhe (ii) pavarësinë individuale të anëtarëve të Këshillit të Pavarur.

(i) Parimet e përgjithshme në lidhje me pavarësinë e Këshillit sipas Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës

83. Gjykata fillimisht thekson që Këshilli i Pavarur është institucion i themeluar me Kushtetutë. Kjo e fundit i ka atribuuar Këshillit të Pavarur (i) cilësimin e institucionit "*të pavarur*" në lidhje me (ii) ushtrimin e funksionit të tij kushtetues, përkatësisht, *"sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil"*. Më saktësisht, paragrafi 2 i nenit 101 të Kushtetutës, (i) përcakton saktë emërtimin e Këshillit Mbikëqyrës si i "*pavarur*"; dhe (ii) këtë "*pavarësi*" ia ka atribuuar me qëllim të "*sigurimit të respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil"*. Për pasojë, qëllimi i dispozitës përkatëse kushtetuese reflekton pavarësinë institucionale të Këshillit të Pavarur me qëllim të ushtrimit të funksionit të tij për "*sigurimin e respektimit të parimeve dhe rregullave që rregullojnë shërbimin civil*". Ushtrimi i pavarur i këtij funksioni sigurohet përmes vendimmarrjes së pavarur të anëtarëve të vet Këshillit të Pavarur.

84. Gjykata gjithashtu vëren se e njëjta pavarësi i është përcaktuar Këshillit të Pavarur përmes Ligjit për KPMSHCK-në. Neni 6 (Funksionet e Këshillit) i Ligjit për KPMSHCK-në, ndër tjerash, përcakton se: "*Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil; 1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civilë."* Rrjedhimisht, funksioni i pavarur i Këshillit të Pavarur përkitazi me "*sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil"* realizohet përmes kompetencës së tij, përkatësisht anëtarëve të tij, për marrjen e vendimeve lidhur me ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

85. Në këtë kontekst, dhe përmes një numër vendimesh të saj, Gjykata ka trajtuar natyrën e vendimeve të Këshillit të Pavarur, duke theksuar përmes praktikës së saj gjyqësore, duke e përfshirë rastin e saj KI33/16, që Këshilli i Pavarur gëzon prerogativat e një gjykate në kuptim të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Përmes kësaj praktikë gjyqësore, Gjykata ka theksuar se *"gjykata"* kategorizohet në kuptimin substancial të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë vendosja e çështjeve brenda kompetencave të saj në bazë të rregullave të së drejtës dhe pas procedurave të kryera në

mënyrë të paraparë [...], duke përcaktuar se vendimet e Këshillit të Pavarur janë *"përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme"* dhe se Këshilli i Pavarur nga plotëson kriteret e një "tribunali" sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, pasi, mes tjerash,(a) është i pavarur prej ekzekutivit; dhe (b) ka juridiksion të plotë për të vendosur për çështjet që vendosen para tij ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës KI33/16, *Minire Zeka*, Aktgjykim i 6 korrikut 2016, paragrafi 59; ndërsa në lidhje me pavarësinë e një *"tribunali të pavarur",* shih, rastin KO12/17, parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 9 majit 2017, paragrafi 75; si dhe rastin KO171/18, cituar më lart, paragrafi 163).

86. Për më shumë, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar që Këshilli i Pavarur kualifikohet si institucion *"kuazi gjyqësor"*, përkatësisht si tribunal përkitazi me zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga shërbimi civil (emërtimi *"tribunal"* gjen përdorim më të gjerë në diskursin e GJEDNJ-së). Rrjedhimisht, Këshilli i Pavarur gëzon prerogativat e një "*gjykate*" pikërisht për shkak të pavarësisë nga ekzekutivi dhe legjislativi dhe kualifikohet si institucion që ka juridiksion të plotë që të nxjerr vendime të detyrueshme, në lidhje me konfliktet në mes të shërbyesve civil ose kandidatëve për shërbyes civil në njërën anë, dhe institucioneve që kanë të punësuar nëpunësit civil, në anën tjetër (shih, rastin e Gjykatës KO171/18, cituar më lart, paragrafi 165).

87. Sigurisht që ligjshmëria e vendimeve të Këshillit të Pavarur i nënshtrohet më tej kontrollit të pushtetit gjyqësor, përmes inicimit të konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda kushteve dhe afateve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Konfliktin Administrativ, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 22 (Inicimi i konfliktit administrativ) të Ligjit për KPMSHCK-në. Rrjedhimisht, kontrolli, përkatësisht vlerësimi i ligjshmërisë së vendimeve të Këshillit të Pavarur, është kompetencë e pushtetit gjyqësor.

88. Marrë parasysh të lartcekurat, përkatësisht dispozitat kushtetuese, ligjore dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, përkitazi me pavarësinë e Këshillit të Pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij dhe natyrën e vendimeve të nxjerra nga i njëjti, Gjykata në vijim do të shtjellojë parimet që ndërlidhen me pavarësinë e anëtarëve të Këshillit të Pavarur.

(ii) Pavarësia individuale e anëtarëve të Këshillit të Pavarur

89. Gjykata rithekson se Këshilli i Pavarur është institucion i themeluar me Kushtetutë dhe të cilit kjo e fundit, i ka përcaktuar (i) cilësimin e

institucionit "*të pavarur*" në lidhje me (ii) ushtrimin e funksionit të tij kushtetues, përkatësisht, *"sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil"*. Sigurimi i respektimit të këtyre rregullave dhe parimeve realizohet përmes vendimmarrjes së anëtarëve të Këshillit të Pavarur. Si rezultat i këtij funksioni që Kushtetuta ia ka atribuuar Këshillit të Pavarur, përmes praktikës së saj gjyqësore, Gjykata ka vënë theks në (i) cilësimin e Këshillit si institucion *"kuazi gjyqësor"*, përkatësisht si tribunal përkitazi me zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga shërbimi civil; dhe (ii) faktin që vendimet e Këshillit të Pavarur janë *"përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme"*. Sigurisht që pavarësia kushtetuese e Këshillit të Pavarur përkitazi me funksionin e tij kushtetues në *"sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil",* ngërthen edhe pavarësinë e anëtarëve të Këshillit të Pavarur përkitazi me vendimmarrjen e tyre.

90. Në kontekst të kësaj pavarësie, Kuvendi, përmes miratimit të Ligjit për KPMSHCK-në, u ka siguruar anëtarëve të Këshillit të Pavarur imunitet përkitazi me vendimmarrjen e tyre. Më saktësisht, paragrafi 3 i nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në, përcakton që "*Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi*". Kjo dispozitë është vlerësuar edhe nga Gjykata përmes Aktgjykimit në rastin KO171/18, dhe pas shqyrtimit të praktikave përkatëse gjyqësore por edhe raporteve relevante të Komisionit të Venecias, është vlerësuar *"në pajtueshmëri me Kushtetutën"*.

91. Sigurisht që, bazuar në po të njëjtin Aktgjykim, imuniteti funksional, që u garantohet anëtarëve të Këshillit të Pavarur sipas Ligjit të KPMSHCK-së, është i limituar dhe nuk përfshin veprimet jashtë fushëveprimit të tyre si anëtarë të Këshillit të Pavarur, duke përfshirë nëse ata akuzohen për vepra penale, që nuk ndërlidhen thjesht me faktin që ata kanë ushtruar funksionet e tyre që ndërlidhen me pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre si anëtarë të Këshillit të Pavarur. Ata gjithashtu nuk kanë imunitet as nga arrestimi (shih, rastin e Gjykatës KO171/18, cituar më lart, paragrafi 244). Gjykata ka vlerësuar se qëllimi i imunitetit, të cilin anëtarët e Këshillit të Pavarur e gëzojnë, është që të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre, me theks në vendimmarrje (shih rastin e Gjykatës KO171/18, cituar më lart, paragrafi 247).

92. Për më tepër, pavarësia individuale të anëtarëve të Këshillit të Pavarur në kuptim të vendimmarrjes përfshin edhe të shprehurit e kësaj

pavarësie jo vetëm përballë ndikimeve të jashtme që mund të kenë anëtarët e Këshillit të Pavarur, por edhe përballë ndikimeve nga organi, i cili i ka emëruar në pozitat përkatëse, përkatësisht Kuvendi. Gjykata rikujton që një pavarësi të tillë, Kushtetuta iu ka atribuuar edhe agjencive të pavarura, të cilat në fakt themelohen nga vet Kuvendi përmes nenit 142 të Kushtetutës. Gjykata thekson se kjo pavarësi, ngërthen qëllimin që anëtarët e agjencive përkatëse të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre kushtetuese dhe ligjore.

93. Gjykata, më tej, gjithashtu vëren se Ligji për KPMSHCK-në, përkatësisht neni 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) i tij, përcakton rastet e ndërprerjes së mandatit të anëtarit të Këshillit të Pavarur nga Kuvendi sipas propozimit nga Komisioni përkatës i Kuvendit për administratë publike apo shumicës e anëtarëve të vet Këshillit, duke u kufizuar në shkaqet vijuese: (i) për shkelje të dispozitave të Ligjit për KPMSHCK-në; (ii) kur kryen veprimtari, që krijon konflikt të interesit dhe përkundër paralajmërimit nga organi kompetent nuk e eliminon konfliktin e interesit sipas ligjit përkatës; (iii) në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij; dhe (iv) në rast të mungesës pa arsye në punë mbi pesë (5) ditë për arsyet që nuk parashihen me ligj.

94. Megjithatë, marrë parasysh formulimin e (i) paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës; (ii) praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të sqaruar më lart; dhe (iii) leximin e përbashkët të nenit 15 dhe paragrafit 3 të nenit 11 të Ligjit për KPMSHCK-në, përkatësisht mundësinë e ndërprerjes së mandatit të anëtarit të Këshillit të Pavarur nga Kuvendi dhe imunitetin, të cilin ua ka përcaktuar i njëjti përkitazi me shkarkimin lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit të Pavarur, Gjykata thekson se anëtari i Këshillit nuk mund të shkarkohet për arsye të vendimmarrjes, përkatësisht mënyrës së votimit gjatë shqyrtimit të rasteve konkrete. Ligjshmëria e vendimmarrjes së tillë në fakt dhe siç është sqaruar më lart, i takon pushtetit gjyqësor, përmes procedurës së konfliktit administrativ siç është përcaktuar në nenin 22 të Ligjit për KPMSHCK-në.

III. Sa i përket kompetencës së Kuvendit për mbikëqyrjen e Këshillit të Pavarur

95. Kompetenca e Kuvendit për të mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit është e përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës. Në rastin e

Këshillit të Pavarur, kjo kompetencë e Kuvendit është më tej e detajuar përmes Ligjit për KPMSHCK-në. Më saktësisht, përmes (i) nenit 4 (Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës) dhe nenit 28 (Raporti vjetor i Këshillit), sipas të cilëve përcaktohet detyrimi i Këshillit të Pavarur që për punën e tij t'i raportojë Kuvendit, së paku njëherë në vit, dhe sa herë që i kërkohet nga Kuvendi dhe procedura përkatëse; (ii) paragrafit 1 të nenit 8 (Përbërja e Këshillit) dhe nenit 10 (Procedura për emërimin e anëtarëve të Këshillit), të cilët përcaktojnë kompetencën e Kuvendit për të emëruar anëtarët e Këshillit të Pavarur dhe procedurën përkatëse; (iii) nenit 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit), i cili përcakton bazat ligjore mbi të cilat mund të ndërprehet mandati i një anëtari të Këshillit të Pavarur dhe procedura që duhet ndjekur; dhe (iv) nenit 27 (Financimi i Këshillit), i cili përcakton pavarësinë buxhetore të Këshillit të Pavarur, por edhe detyrimin e tij që për kontributet e pranuara nga donatorët, ta njoftojë Kuvendin. Për më tepër, Gjykata thekson që vet Kuvendi përmes Ligjit për KPMSHCK-në, përkatësisht neneve 23 (Procedura në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit) dhe 24 (Sanksionet administrative për moszbatimin e vendimit të Këshillit) të tij, ka vënë theks në rëndësinë e zbatimit të vendimeve të Këshillit të Pavarur, duke përcaktuar edhe procedurën që duhet ndjekur në rast se një i tillë nuk zbatohet, sanksionet përkatëse si dhe detyrimin e Këshillit të Pavarur që Kuvendi të njoftohet në raste të tilla.

96. Nisur nga këto norma kushtetuese dhe ligjore, Gjykata fillimisht thekson që është i padiskutueshëm autorizimi i Kuvendit që bazuar në paragrafin 9 të neni 65 të Kushtetutës, të mbikëqyrë Këshillin e Pavarur. Mekanizmat e kësaj mbikëqyrjeje janë më tej të përcaktuar në Ligjin për KPMSHCK-në dhe e njëjta materializohet përmes së trupave parlamentare siç janë komisionet e përhershme, komisionet funksionale dhe komisionet *ad hoc*, të cilat në bazë të paragrafit 1 të nenit 77 [Komisionet] të Kushtetutës, Kuvendi i emëron, e që në rastin konkret, rezulton të jetë Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike.

97. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu rikujton se edhe Komisioni i Venecias ka trajtuar rolin mbikëqyrës të Kuvendit, e veçanërisht punën e Komisioneve dhe në Opinionin e saj, ka theksuar se komisionet e përhershme, duhet të ushtrojnë kontroll efikas në fushën e tyre të kompetencës, i cili nuk duhet të kufizohet në shqyrtimin e raporteve të paraqitura nga organet dhe zyrtarët e shtetit, por duhet gjithashtu të përfshijë një kontroll më aktiv të veprimeve të ekzekutivit dhe agjencive të pavarura (shih, Opinionin nr. 845/2016 të Komisionit të Venecias me titull *"Parametrat në Marrëdhënien në mes të*

Shumicës Parlamentare dhe Opozitës në Demokraci", CDL-AD (2019) 015 i 24 qershorit 2019, paragrafi 92).

98. Prandaj, Gjykata vëren se kompetenca e mbikëqyrjes së Këshillit të Pavarur nga ana e Kuvendit nuk kufizohet vetëm në raportim të thjeshtë periodik, por i njëjti mund edhe të vendosë për shkarkimin e anëtarëve të caktuar të Këshillit të Pavarur, bazuar në nenin 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në, i cili përcakton që propozimin për shkarkim të anëtarit të Këshillit të Pavarur kanë të drejtë ta bëjnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Pavarur ose Komisioni përkatës i Kuvendit për Administratë Publike, dhe përcakton që Kuvendi me shumicë të votave mund të shkarkojë anëtarin e Këshillit të Pavarur për shkak të arsyeve si në vijim: (i) për shkelje të dispozitave të Ligjit për KPMSHCK-në, siç është përcaktuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 15; (ii) kur kryen veprimtari, që krijon konflikt të interesit dhe përkundër paralajmërimit nga organi kompetent nuk e eliminon konfliktin e interesit sipas ligjit përkatës, siç është përcaktuar në pikën 1.2 të paragrafit 1 të nenit 15; (iii) në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij, siç është përcaktuar në pikën 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15; dhe (iv) mungon pa arsye në punë mbi pesë (5) ditë për arsyet që nuk parashihen me ligj, siç është përcaktuar në pikën 1.4 të paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në.

99. Megjithatë, ushtrimi i kompetencës së mbikëqyrjes nga Kuvendi, i përcaktuar përmes paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës, është i kufizuar nga raporti përkatës me paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës në kuptim të pavarësisë së Këshillit të Pavarur në ushtrimin e funksionit të tij kushtetues, ndërsa ushtrimi i kompetencës së shkarkimit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur nga Kuvendi, kontestues në rrethanat e rastit konkret, është i kufizuar edhe nga raporti në mes (i) paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës dhe Ligjit për KPMSHCK-në; dhe (ii) nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në, që përcakton mundësinë e ndërprerjes së mandatit dhe paragrafit 3 të nenit 11 të Ligjit për KPMSHCK-në, që përcakton imunitetin nga shkarkimi përkitazi me vendimmarrjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur.

100. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, Rekomandimi i Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike për shkarkim të anëtarëve të Këshillit të Pavarur dhe për pasojë edhe Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e të njëjtëve, bazohet në pikat 1.1. dhe 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në. Përderisa, Ligji për KPMSHCK-në përcakton kompetencën e Kuvendit për të ndërprerë mandatin e

anëtarëve të Këshillit të Pavarur në rastet dhe nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj, Gjykata, bazuar në parimet e shtjelluar më lart, në vijim, duhet të vlerësojë nëse mënyra e ushtrimit të një kompetencë të tillë të Kuvendit, mund të ketë rezultuar (i) në tejkalimin e autorizimeve të përcaktuara përmes paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës; dhe (ii) cenimin e garancioneve, të përcaktuara përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës.

Aplikimi i parimeve të lartpërmendura në rastin konkret

101. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesës, ndër tjerash, dhe në kontekst të Vendimit të kontestuar, theksojnë se bazuar në paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës, Këshilli është organ i pavarur dhe i vetmi që ka kompetencë për ruajtjen e integritetit profesional të shërbimit civil dhe se përmes Vendimit të kontestuar, Kuvendi ka ndërhyrë në mënyrë kundër-kushtetuese në pavarësinë e funksionit të Këshillit të Pavarur. Për më tepër, ata gjithashtu theksojnë që bazuar në arsyetimin e Vendimit të kontestuar, nuk ekziston asnjë fakt i paraqitur: (i) që dëshmon se anëtarët e Këshillit të Pavarur kanë shkelur Ligjin për KPMSHCK-në; (ii) që dëshmon se anëtaret e shkarkuar të Këshillit të Pavarur kanë kryer veprimtari, që krijon konflikt të interesit; (iii) që dëshmon se anëtarët e shkarkuar të Këshillit të Pavarur kanë kryer detyrat në papajtueshmëri me funksionin e tyre; ose (iv) që dëshmon se anëtarët e shkarkuar të Këshillit të Pavarur kanë munguar pa arsye në punë mbi pesë (5) ditë për arsyet që nuk parashihen me ligj, siç përcaktohet me nenin 15 të Ligjit për KPMSHCK-në. Në anën tjetër, Gjykata rikujton argumentet e deputetes Xhelili-Kica, e cila thekson se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë të qartë procesin ligjvënës dhe funksionin mbikëqyrës të Kuvendit, ngase për t'u vlerësuar një akt i Kuvendit në aspektin kushtetues do të duhej që Kushtetuta të përcaktojë shprehimisht të paktën se cila është procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Pavarur, madje edhe procedurën e shkarkimit.

102. Në kontekst të këtyre pretendimeve, Gjykata tashmë ka theksuar që (i) pavarësia e Këshillit të Pavarur është e përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës, në kuptim të funksionit të tij kushtetues për të "*siguruar respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil*"; (ii) funksioni kushtetues i "*sigurimit të respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil*", realizohet përmes vendimmarrjes së pavarur të anëtarëve të Këshillit të Pavarur, përkatësisht pavarësisë së funksionit të tyre individual; (iii) bazuar në praktikën gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës, Këshilli i Pavarur cilësohet si institucion *"kuazi gjyqësor" dhe se* vendimet e tij janë *"përfundimtare, të detyrueshme dhe të*

ekzekutueshme", cilësim ky të cilin ia ka atribuuar edhe vet Kuvendi, ndër tjerash, përmes Ligjit për KPMSHCK-në, duke përfshirë nenet 23 dhe 24 të tij; (iv) Kuvendi bazuar në paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës dhe bazuar në dispozitat e Ligjit për KPMSHCK-në, ka kompetencën e mbikëqyrjes së Këshillit të Pavarur, përmes mekanizmave të përcaktuara në ligjin e lartcekur, duke përfshirë edhe kompetencën e ndërprerjes së mandatit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur; dhe (v) kompetenca e Kuvendit për mbikëqyrjen e Këshillit të Pavarur dhe anëtarëve të tij, duhet të ushtrohet në përputhje me garancitë institucionale të Këshillit të Pavarur të përcaktuara përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të Ligjit për KPMSHCK-në.

103. Në vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, ushtrimi i kompetencës së mbikëqyrjes së Kuvendit, siç është përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës, ka tejkaluar autorizimet përkatëse në cenim të garancive institucionale të Këshillit të Pavarur, siç janë përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se përmes Vendimit të kontestuar, pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur janë shkarkuar në mënyrë kolektive. Rekomandimi përkatës i Komisionit për Administratë Publike, i cili i ka paraprirë Vendimit të kontestuar, kishte arsyetuar si në vijim:

[...] Rekomandimi për inicimin për shkarkimin e anëtareve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, bëhet sipas nenit 15, paragrafi 1, pika 1 dhe 3, si në vijim:

1.1 për shkelje të dispozitave të ligjit për KPMSHCK-në;
1.3 në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij;

Komisioni në mbledhjen e mbajtur me 01.06.2021, ka shqyrtuar raportin vjetor të punës së KPMSHCK-së, dhe i ka rekomanduar Kuvendit mosmiratimin e [tij].
Në mbledhjen e mbajtur me 15.06.2021, është diskutuar lidhur me shkeljet e anëtarëve të [Këshillit]. Me këtë rast, është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK, për arsye se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes [...]".

104. Gjykata rikujton që bazuar në këtë Rekomandim, Kuvendi ka nxjerrë Vendimin për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur. Ky Vendim i Kuvendit, përmban dy pika. E para, përcakton që "*shkarkohen pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës së*

Shërbimit Civil të Kosovës", duke listuar pesë (5) emrat përkatës. Ndërsa, e dyta, thjeshtë përcakton që "*Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit*".

105. Duke marrë parasysh që Vendimi i kontestuar i Kuvendit nuk përmban asnjë sqarim shtesë përkitazi me shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur, Gjykata duke u referuar në përmbajtjen e Rekomandimit të Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, vëren se anëtarët e Këshillit të Pavarur janë shkarkuar në mënyrë kolektive, nën arsyetimin se (i) kanë bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për KPMSHCK-në, siç është përcaktuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 15 të tij; dhe (ii) kanë kryer detyra në papajtueshmëri me funksionin e tyre, siç është përcaktuar në pikën 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15 të tij. Rekomandimi përkatës për më tepër thekson se "*është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK, për arsye se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes.*"

106. Në vijim, Gjykata do të analizojë Vendimin e kontestuar të Kuvendit për shkarkimin kolektiv të pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur, duke u referuar në bazat ligjore mbi të cilat është nxjerrë, duke filluar me (i) pikën 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në; për të vazhduar me (ii) pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në.

107. Lidhur me arsyetimin e Kuvendit, përkatësisht arsyetimin e ngërthyer në Rekomandimin e Komisionit të Kuvendit për Administratën Publike, Gjykata vëren se pika 1.3 e paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në përcakton mundësinë e ndërprerjes së mandatit "*në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij*". Rastet e papajtueshmërisë së funksionit të anëtarit të Këshillit të Pavarur janë shprehimisht të përcaktuara në Ligjin për KPMSHCK-në, përkatësisht në paragrafin 2 të nenit 11 të tij, dhe i cili përcakton që "*anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marr pjesë në aktivitete politike*". Rekomandimi, përkatësisht, Vendimi i kontestuar i Kuvendit, nuk përmban (i) asnjë referencë në paragrafin 2 të nenit 11 të Ligjit për KMPSHCK-në; dhe (ii) asnjë fakt apo arsyetim se si pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur mund të kenë ushtruar detyrat e anëtarit të Këshillit të Pavarur në papajtueshmëri me funksionin e tyre, përkatësisht mund të kenë ushtruar ndonjë funksion tjetër shtetëror, mund të kenë ushtruar funksionin e një anëtari të një partie politike ose mund të kenë marrë pjesë në aktivitete politike.

108. Ndërsa, lidhur me arsyetimin e Kuvendit, përkatësisht arsyetimin e ngërthyer në Rekomandimin e Komisionit të Kuvendit për Administratën Publike, Gjykata vëren se pika 1.1 e paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në përcakton mundësinë e ndërprerjes së mandatit "*për shkelje të dispozitave të këtij ligji*". Rekomandimi, përkatësisht Vendimi i kontestuar, nuk përmban asnjë fakt e arsyetim se si pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur mund të kenë të ushtruar detyrat e anëtarit të Këshillit të Pavarur "*në shkelje të dispozitave të këtij ligji*".

109. Gjykata vëren megjithatë që Rekomandimi i Komisionit të Kuvendit për Administratën Publike që ka rezultuar në Vendimin e kontestuar të Kuvendit, thekson se "*është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK, për arsye se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes.*" Në këtë kontekst, Gjykata i referohet përmbajtjes së nenit 12 të Ligjit për KPMSHCK-në, i cili përcakton detyrat e anëtarëve të Këshillit të Pavarur, si në vijim: (i) që të ushtrojnë funksionin e anëtarit në mënyrë të paanshme dhe të vendosin në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin; (ii) të ruajnë autoritetin dhe imazhin e Këshillit të Pavarur; dhe që (iii) secili anëtar ka për detyrë të marr pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Këshillit të Pavarur, si dhe të kryejë punët e tjera të caktuara me ligj, me rregulloren e punës dhe aktet tjera nënligjore të Këshillit të Pavarur. Gjykata vëren se Rekomandimi i lartcekur bazuar në të cilin është nxjerrë Vendimi i kontestuar i Kuvendit, nuk i referohet asnjë fakti e arsyetimi në mbështetje të shkeljes së pretenduar të kësaj dispozite nga pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur kolektivisht.

110. Për më tepër, Gjykata thekson se përmbajtja e nenit 12 të Ligjit për KPMSHCK-në, thjeshtë përcakton detyrimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur që (i) të ushtrojnë funksionin e anëtarit në mënyrë të paanshme dhe të vendosin në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin duke e ruajtur autoritetin dhe imazhin e Këshillit; (ii) secili anëtar ka për detyrë të marr pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Këshillit të Pavarur; dhe (iii) secili anëtar ka për detyrë të kryejë punët e tjera të caktuara me ligj, me rregulloren e punës dhe aktet tjera nënligjore të Këshillit të Pavarur. I vetmi arsyetim i Rekomandimit që ka rezultuar në Vendimin e kontestuar të Kuvendit, në kuptim të "*shkeljes së dispozitave të këtij ligji*", siç është përcaktuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 15, është se pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur kolektivisht "*nuk kanë zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes.*" Duke marrë parasysh që Rekomandimi/Vendimi i kontestuar i Kuvendit nuk përmban asnjë fakt e arsyetim shtesë përkitazi me shkeljen e dispozitave të ligjit, përpos referimit në

"*vendimmarrjen*" e anëtarëve të Këshillit të Pavarur, përkatësisht pretendimin për moszbatimin e "*ligjeve të aplikueshme gjatë vendimmarrjes*", rezulton se pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur janë shkarkuar përkitazi me vendimmarrjen e tyre në ushtrimin e funksionit për të "*siguruar respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil*", siç është përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës.

111. Përtej përmbajtjes së vet Rekomandimit/Vendimit të kontestuar, sipas të cilit, anëtarët e Këshillit të Pavarur janë shkarkuar për "*vendimmarrje*", Gjykata gjithashtu rikujton se veprimet e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, përmes pyetjeve specifike në raste konkrete dhe kërkimit të dosjeve, të cilat i kanë paraprirë Vendimit të kontestuar, konsistojnë në një kontroll të punës së Këshillit të Pavarur në rolin e tyre si vendimmarrës në rastet e parashtruara pranë tij.

112. Më specifikisht, Rekomandimi i lartcekur i Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike për shkarkimin të anëtarëve të Këshillit të Pavarur ka vijuar pas (i) mos miratimit të raportit vjetor të Këshillit të Pavarur; (ii) pyetjeve të parashtruara nga deputetët në seancën e Komisionit Parlamentar për Administratë Publike lidhur me performancën e Këshillit; dhe (iii) komunikimit përmes Sekretarisë së Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, duke kërkuar informata shtesë dhe qasje në dosje specifike të rasteve të Këshillit të Pavarur. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike kishte parashtruar pyetje specifike përkitazi me vendimmarrjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur dhe specifikisht lidhur me: (i) të gjitha lëndët që kanë qenë në pritje para se Këshilli të Pavarur të vendoste për lëndën që ishte diskutuar në Komision (rasti i N.K.-së), përfshirë por pa u kufizuar në evidentimin e numrit të lëndëve paraprake para se të vendoset për këtë rast; dhe (ii) numrin e saktë të të gjitha lëndëve në pritje, data e saktë e parashtrimit të secilës ankese/kërkesë/parashtresë që ka qenë në pritje dhe është dorëzuar para lëndës së N.K.-së, e që megjithatë nuk është trajtuar para kësaj lënde. Po ashtu, ky Komision kërkoi edhe informatat si në vijim: (i) a janë trajtuar të gjitha rastet që u evidentuan si në pritje në pyetjen paraprake, brenda afatit dyzet e pesë (45) ditësh, dhe të konfirmohet në qoftë se të gjitha këtyre rasteve nuk ka pasur nevojë t'i jepet kohë shtesë për trajtim, por ka mjaftuar afati në fjalë apo ajo që ka mbetur nga ky afat me rastin e bartjes; dhe me rastin e dërgimit të këtij sqarimi, Zyra Koordinuese e Komisionit kërkoi edhe që (ii) t'i dërgohen edhe datat e vendimmarrjes për rastet që u identifikuan si në pritje në pyetjen paraprake; dhe (iii) të bashkëlidhin dosjen e plotë të rastit të N.K.-së.

113. Në kontekst të të lartcekurave, Gjykata rikujton parimet e përgjithshme në kuptim të paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës dhe se bazuar në po të njëjtin, Këshilli i Pavarur është organ i pavarur, i cili duhet të sigurojë respektimin e rregullave dhe parimeve të shërbimit civil, respektimin e të cilave e bën përmes vendimmarrjes në rastet e parashtruara pranë tij, dhe e cila nënkupton pavarësinë individuale të anëtarëve të Këshillit të Pavarur në shqyrtimin e rasteve konkrete.

114. Për më tepër Gjykata, rikujton që (i) anëtarët e Këshillit të Pavarur gëzojnë pavarësi në vendimmarrjen e tyre në "*sigurimin respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil*", siç përcakton paragrafit 2 i nenit 101 të Kushtetutës; (ii) kjo pavarësi është me tej e përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës në rastin KO171/18 dhe dispozitave ligjore, përkatësisht paragrafin 3 të nenit 11 të Ligjit për KPMSHCK-në, i cili anëtarëve të Këshillit të Pavarur u atribuon imunitet lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit të Pavarur, nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi, i cili ua mundëson që të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre në lidhje me *"pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre";* (iii) përderisa Kuvendi ka kompetencë kushtetuese të mbikëqyrë Këshillin e Pavarur, duke përfshirë mundësinë e ndërprerjes së mandatit të anëtarëve të tij në rastet e përcaktuara në Ligjin për KPMSHCK-në, anëtarët e Këshillit të Pavarur nuk mund të shkarkohen vetëm për vendimmarrje sepse përkitazi me të njëjtën kanë imunitet nga shkarkimi, siç është përcaktuar në vet ligjin që e ka miratuar Kuvendi. Për më tepër që, bazuar në po të njëjtin ligj, ligjshmëria e vendimeve të Këshillit të Pavarur i nënshtrohet kontrollit të pushtetit gjyqësor dhe jo atij legjislativ.

115. Gjykata duke u bazuar në pavarësinë e Këshillit të Pavarur, natyrën e vendimeve që Këshilli i Pavarur nxjerr dhe në imunitetin funksional që anëtarët e Këshillit të Pavarur gëzojnë, konsideron se të njëjtit nuk mund të thirren në përgjegjësi për mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre, sepse kjo do cenonte pavarësinë e tyre në ushtrimin e kompetencave si anëtarë të Këshillit të Pavarur, siç garantohet me parimet e mishëruara në paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës.

116. Gjykata rikujton se një anëtari të Këshillit të Pavarur, Kuvendi nuk mund t'ia kontrollojë arsyeshmërinë e vendimmarrjes meqenëse ato janë të mbrojtura me parimin e pavarësisë së vendimmarrjes së Këshillit të Pavarur, vendimmarrje kjo e ndërlidhur me "*sigurimin e*

respektimit të parimeve dhe rregullave të shërbimit civil" sipas paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës, dhe e mbrojtur përmes imunitetit nga shkarkimi sipas paragrafit 3 të nenit 11 të Ligjit për KPMSHCK-në.

117. Është detyrë e Kuvendit të mbikëqyrë, por, gjithashtu të ruajë pavarësinë e Këshillit të Pavarur, ashtu siç vetë e ka përcaktuar me Kushtetutë dhe Ligjin për KPMSHCK-në. Kjo nënkupton, ndër tjerash, jo vetëm detyrën e përzgjedhjes së anëtarëve përmes një procesi të hapur, transparent dhe të bazuar në meritokraci, por edhe ndërprerjen eventuale të mandatit përkatës në baza individuale, duke argumentuar saktësisht faktet e arsyet për një propozim të tillë, bazuar në ato rrethanat për të cilat ligji lejon ndërprerjen e mandatit, dhe jo pritjeve të caktuara apo ndërhyrjeve të ligjvënësit për vendimet që anëtari i Këshillit të Pavarur ka marrë apo duhej të merrte. Gjykata rithekson se vendimmarrja e anëtarëve të Këshillit të Pavarur në raste konkrete mund të sfidohet nga pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit të Pavarur nuk është i ligjshëm, duke iniciuar konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Konfliktin Administrativ siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 22 të Ligjit për KPMSHCK-në.

118. Prandaj, Gjykata konstaton se Kuvendi duke shkarkuar anëtarët e Këshillit të Pavarur në bazë të paragrafit 1, pikave 1.1. dhe 1.3. të nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në, pa përfshirjen në Rekomandimin e Komisionit përkatës dhe Vendimin e kontestuar të Kuvendit, të asnjë fakti e të bazuar në ligj, përkitazi me shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur në mënyrë kolektive, por vetëm me arsyetimin se Këshilli i Pavarur *"nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes",* përkatësisht për shkak të vendimmarrjes së tyre në raste konkrete, për të cilën anëtarët e Këshillit të Pavarur gëzojnë imunitet nga shkarkimi, siç përcaktohet me paragrafin 3 të nenit 11 të Ligjit për KPMSHCK-në dhe e cila vendimmarrje, për më tepër, i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë nga pushteti gjyqësor në procedurën e konfliktit administrativ, siç është përcaktuar në nenin 22 të Ligjit për KPMSHCK-në, ka tejkaluar kufijtë e kompetencës së mbikëqyrjes së punës së institucioneve publike, të përcaktuar me paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës në cenim të garancive përkitazi me pavarësinë e Këshillit të Pavarur në ushtrimin e funksionit të tij, të përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës.

119. Për pasojë dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se Vendimi [nr. 08/V-029] i Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit

101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se Vendimi [Nr.07-V-063] i Kuvendit për zgjedhjen e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur, i 8 tetorit 2020, mbetet në fuqi.

Kërkesa për masë të përkohshme

120. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata që të pranojë nenin 43 të Ligjit, duke iu referuar kështu efektit pezullues *ex-lege* të zbatimit të ligjit apo vendimit të Kuvendit. Parashtruesit e kërkesës, në këtë kontekst, (i) kërkojnë nga Gjykata të informojë palët e përfshira që Vendimi i kontestuar pezullohet *ex-lege* dhe nuk dërgohet për zbatim deri në vendimin final të Gjykatës; dhe (ii) vlerësojnë se nuk është e nevojshme të kërkojnë shprehimisht pezullimin e zbatimit të aktit, përderisa i njëjti sipas ligjit do të duhej të nënshtrohej efektit pezullues në zbatim, meqë është kontestuar pranë kësaj Gjykate, në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës.

121. Më 21 tetor 2021, Gjykata vendosi sipas detyrës zyrtare masën e përkohshme deri më 15 dhjetor 2021, duke arsyetuar se e njëjta përbën interes publik, duke pezulluar kështu menjëherë Vendimin e kontestuar, dhe duke përcaktuar që Kuvendi duhet të përmbahet nga çdo veprim lidhur me çështjen e zgjedhjes së anëtarëve të rinj deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës (për arsyetimin e detajuar rreth arsyeshmërisë së Masës së Përkohshme, shih Vendimin për Masë të Përkohshme në rastin KO127/21, të 21 tetorit 2021).

122. Më 9 dhjetor 2021, Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme dhe vendosi për meritat e saj. Në po të njëjtën datë, Gjykata vendosi gjithashtu që të shfuqizojë Masën e Përkohshme.

Kërkesa për seancë dëgjimore

123. Gjykata rikujton gjithashtu që parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore.

124. Gjykata rikujton paragrafin 2 të rregullit 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës, i cili përcakton që *"Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo të ligjit."*

125. Gjykata vëren se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ai rregull vetëm parasheh mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo

beson se është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit. Rrjedhimisht, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo konsideron se të dhënat ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur te një vendim meritor lidhur me rastin që është në shqyrtim (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës, KI34/17, parashtruese *Valdete Daka,* Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110).

126. Në rastin konkret, Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth *"provave apo ligjit"* dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur meritat e këtij rasti.

127. Rrjedhimisht, Gjykata, njëzëri, e refuzon kërkesën e parashtruesve të kërkesës për caktim të seancës dëgjimore.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.5 dhe 116.2 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 27 të Ligjit, si dhe në mbështetje të rregullit 59 (1) të Rregullores së punës, më 9 dhjetor 2021:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, njëzëri, që Vendimi nr. 08/V-029 i Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

III. TË SHFUQIZOJË, njëzëri, Vendimin nr. 08/V-029 të Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;

IV. TË SHFUQIZOJË, njëzëri, Vendimin për Masë të Përkohshme, të 21 tetorit 2021;

V. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për seancë dëgjimore;

VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim parashtruesve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës, Avokatit të Popullit dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;

VII. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

VIII. TË SHPALLË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bajram Ljatifi	Gresa Caka-Nimani

KI120/19, Parashtrues: Mursel Gashi, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-17-0568, të 14 marsit 2019

KI120/19, Aktgjykim 25 nëntorit 2021, publikuar më 30 dhjetor 2021

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm*

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një numër pronash, njohjen e të cilave parashtruesi i kërkesës, e kishte kërkuar përmes padisë. Më saktësisht, njohja e të drejtës pronësore ishte kërkuar mbi katër (4) ngastra kadastrale, konkretisht ngastrat [nr.588/1], [nr.598], [nr.601] dhe [nr.604], të cilat, sipas kontratës përkatëse të shitblerjes të vitit 1971, ai i kishte blerë por, bazuar në shkresat e lëndës, nuk kishte arritur t'i regjistroj në regjistrin kadastral në emër të tij. Në vitin 2007, dy (2) nga katër (4) ngastrat e lartcekura, përkatësisht ngastrat kadastrale [nr.588] dhe [nr. 598], përmes një Aktgjykimi të Gjykatës Komunale, kishin kaluar në pronësinë e familjes S., pas miratimit të padisë së kësaj të fundit kundër Ndërmarrjes Shoqërore KBI "Kosova-Export". Pasi që Aktgjykimi i lartcekur Gjykatës Komunale u bë i plotfuqishëm, ngastrat kadastrale përkatëse u regjistruan në regjistrin kadastral si pronë e familjes S.

Në vitin 2011, parashtruesi i kërkesës përmes padisë në Dhomën së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, (i) fillimisht kërkoi vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi katër (4) ngastrat e lartcekura; ndërsa më pas (ii) përmes precizimit të kërkesëpadisë kërkoi që përkitazi me dy (2) ngastrat kadastrale të cilat si rezultat i Aktgjykimit të vitit 2007, ishin regjistruar në emër të familjes S, të kompensohet me ngastra tjera të Ndërmarrjes Shoqërore KBI "Kosova-Export".

Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme, e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës, ndërsa pas ankesës së këtij të fundit, në vitin 2017, Kolegji i Apelit ndryshoi vendimin e Kolegjit të Specializuar, duke i njohur parashtruesit të kërkesës të drejtën e pronësisë mbi 4 (katër) ngastrat e lartcekura. Megjithatë, Kolegji i Apelit (i) nuk adresoi çështjen e kompensimit të ngastrave kadastrale me ngastra të tjera, përkundër faktit që sipas precizimit të kërkesëpadisë, ishte sqaruar që dy (2) nga ngastrat kontestuese ishin regjistruar në emër të familjes S., si rezultat i një Aktgjykimi të formës së prerë në vitin 2007; dhe (ii) në përcaktimin e pronësisë së parashtruesit të kërkesës mbi ngastrat përkatëse, kishte përdorur numra identifikues sipas sistemit të vjetër të regjistrit kadastral,

duke rezultuar për pasojë në mospërputhje me sistemin aktual të kadastral. Andaj, parashtruesi i kërkesës iu drejtua sërish Kolegjit të Apelit me kërkesë (i) për korrigjim të Aktgjykimit, përkitazi me identifikimin e saktë të ngastrave kadastrale; dhe (ii) për plotësim të Aktgjykimit, përkatësisht kërkesën që Kolegji i Apelit të vendos për të gjitha kërkesat e saktësuara në ankesë dhe saktësisht përkitazi me kërkesën për kompenzimin me ngastra tjera të ndërmarrjes së lartcekur shoqërore, si rezultat i regjistrimit të dy (2) ngastrave të lartcekura në emër të familjes S.

Në vitin 2019, Kolegji i Apelit, përmes Aktvendimit (i) miratoi kërkesën për korrigjim të Aktgjykimit lidhur me saktësimin e dy (2) ngastrave në përputhje me sistemin e ri kadastral; ndërsa (ii) lidhur kërkesën për kompensimin e dy (2) ngastrave, të cilat tashmë ishin në pronësi të familjes S., e hodhi poshtë si të papranueshme, duke theksuar, në esencë, që "*nuk ka mbetur ndonjë çështje e pazgjidhur*", pasi që parashtruesit të kërkesës i është njohur e drejta e pronësisë mbi katër (4) ngastrat kontestuese, por duke mos e adresuar faktin që dy (2) nga ngastrat pronësinë mbi të cilat ia kishte njohur parashtruesit të kërkesës, tashmë ishin regjistruar në pronësi të familjes S., si rezultat i një Aktgjykimi të formës së prerë.

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendoi se, Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) e nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke theksuar, ndër tjerash, se Kolegji i Apelit përmes pikës (V) të Aktvendimit, kishte hedhur poshtë kërkesën e tij për plotësim të Aktgjykimit, pa adresuar dhe arsyetuar fare pretendimin e tij të bërë përmes precizimin e padisë lidhur me kompensimin e dy (2) ngastrave, tashmë të regjistruara në emër të familjes S., me ngastra të tjera në pronësi të KBI "Kosova Export".

Në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të tij për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata fillimisht shtjelloi dhe më pas aplikoi parimet e praktikës së saj gjyqësore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pas vlerësimit të rrethanave në këtë rast, Gjykata theksoi se nuk ishte kontestuese që dy (2) nga katër (4) ngastrat kontestuese ishin në pronësi të dy pronarëve të ndryshëm, përkatësisht (i) të familjes S., sipas një Aktgjykimi të Gjykatës Komunale të vitit 2007; dhe (ii) parashtruesit të kërkesës sipas vet Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të vitit 2017. Ndërsa, përkundër kërkesës specifike të parashtruesit të kërkesës që kjo çështje të adresohej fillimisht përmes precizimit të kërkesëpadisë dhe më pas përmes kërkesës për plotësimin e Aktgjykimit, Kolegji i Apelit këtë çështje nuk e

kishte adresuar as përmes Aktgjykimit të vitit 2017 dhe as përmes Aktvendimit të vitit 2019.

Gjykata, bazuar në praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore përkitazi me të drejtën në vendim të arsyetuar gjyqësor, theksoi se përderisa detyrimi për të dhënë arsye mbi pretendimet e palëve përkatëse mund të ndryshojë varësisht nga natyra e rastit në shqyrtim, pretendimet thelbësore të palëve duhet të adresohen dhe arsyetohen, dhe se sipas sqarimeve të dhëna të Aktgjykimin e publikuar të Gjykatës, në rrethanat e rastit konkret, ky nuk ishte rasti.

Për pasojë, Gjykata konstatoi se pika (V) e Aktvendimit të kontestuar [AC-I-17-0568] të 14 marsit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe rrjedhimisht, shpalli të njëjtin të pavlefshëm duke e kthyer në rivendosje në pajtueshmëri me konstatimet e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI120/19

Parashtrues

Mursel Gashi

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme
të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë
Kosovare të Privatizimit, AC-I-17-0568, të 14 marsit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Mursel Gashi nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga Visar Vehapi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-17-0568, të 14 marsit 2019, (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së).

3. Aktvendimi i kontestuar AC-I-17-0568 i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 19 mars 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, me të cilin, pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), si dhe me nenet 8, 14 dhe 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 17 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 18 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).

8. Më 1 gusht 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 5 dhjetor 2019, Gjykata i dërgoi një letër shtesë avokatit të parashtruesit të kërkesës në të cilën kërkoi nga ai që të dorëzojë dokumentacion shtesë, si dhe dëshminë se kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës, apo përfaqësuesit të tij, Aktvendimi i kontestuar AC-I-17-0568 i Kolegjit të Apelit.

10. Më 9 dhjetor 2019, avokati i parashtruesit të kërkesës i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin shtesë të kërkuar, si dhe dëshminë mbi dorëzimin e Aktvendimit të kontestuar.

11. Më 26 nëntor 2020, Gjykata kërkoi nga DHPGJS dorëzimin e dosjes së plotë të lëndës.

12. Më 1 dhjetor 2020, DHPGJS dorëzoi dosjen origjinale në Gjykatë.

13. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.

14. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

15. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama–Hajrizi, përmes Vendimit nr. KI48/21, caktoi gjyqtarin Safet Hoxha si anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.

16. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

17. Më 6 tetor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe kërkoi plotësimin e raportit.

18. Më 25 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Më 23 korrik 1971, parashtruesi i kërkesës lidhi një kontratë shitblerjeje me shkrim me pronarin - shitësin L.N. nga Matiqani, për blerjen e katër (4) ngastrave kadastrale, të cilat kanë qenë të shënuara si:
Ngastra kadastrale nr. 2/257/28, vendi i quajtur "Gavrilova Njiva" i klasit të 5-të, në sipërfaqe prej 1.56.00 ha,
Ngastra kadastrale nr. 2/257/37, vendi i quajtur "Vasina Njiva" klasit të 5-të, në sipërfaqe prej 1.05.00 ha,
Ngastra kadastrale nr. 2/257/40, vendi i quajtur "Slanište" i klasit të 5-të, në sipërfaqe prej 0.41.00 ha,
Ngastra kadastrale nr. 2/257/43, vendi i quajtur "Slanište" i klasit të 5-të , në sipërfaqe prej 1.03.00 ha. Të gjitha ngastrat kadastrale kanë qenë të evidentuara sipas listës poseduese nr. 45, Zona Kadastrale Matiqan.

20. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, pas vitit 1999, ka pasur një ndryshim në mënyrën e shënimit dhe evidentimit të ngastrave kadastrale në Sistemin Kadastral të Kosovës, dhe se rrjedhimisht parcelat në fjalë kanë marrë numrat nr. 588/1, nr. 598, nr. 601 dhe nr. 604.

21. Në të njëjtën kohë, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, familja S., ka iniciuar procedurën kontestimore kundër Ndërmarrjes Shoqërore KBI-Kosova-Export nga Fushë Kosova. Familja S., në atë kërkesëpadi ka kërkuar që Ndërmarrja Shoqërore KBI-Kosova-Export, t'u ndajë atyre dy ngastra kadastrale si një lloj kompensimi për dy ngastrat e tyre të cilat nuk ishte e mundur t'u kthehen për shkak se ato tanimë u ishin ndarë personave të tretë.

22. Më 20 shkurt 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë miratoi kërkesëpadinë e familjes S., si të bazuar dhe nxori Aktvendimin C.nr. 645/04. Me atë aktvendim Gjykata Komunale i ndau familjes S., ngastrën kadastrale nr. 588, dhe ngastrën kadastrale nr. 598, si një lloj kompensimi për dy ngastrat e tyre. Në ndërkohë Aktvendimi C. nr. 645/04 i Gjykatës Komunale u bë i plotfuqishëm, dhe kësisoj ngastrat kadastrale nr. 588 dhe nr. 598 u regjistruan në kadastër si pronë e familjes S.

23. Më 26 shkurt 2007, parashtruesi i kërkesës parashtroi një kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë në të cilën kërkoi vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi ngastrat në fjalë. Në kërkesëpadi parashtruesi i kërkesës ka deklaruar se *"se si pronar i ri ai ka hyrë në posedim të kësaj patundshmërie në ditën e blerjes, mirëpo për shkak të rrethanave politike të asaj kohe, ai nuk ka arritur që ta regjistroj atë në emër të tij në Drejtorinë Kadastrale në Prishtinë"*.

24. Më 2 mars 2007, parashtruesi i kërkesës i parashtroi një propozim Gjykatës Komunale në Prishtinë në të cilin kërkoi nga gjykata që të caktojë masën e përkohshme për ngastrat kadastrale nr. 588/1, nr. 598, nr. 601 dhe nr. 604, në mënyrë që të pamundësohet tjetërsimi apo ngarkesa ligjore e ngastrave në fjalë.

25. Më 16 prill 2007, Gjykata Komunale nxori Aktvendimin E. nr. 317/07, me të cilin e caktoi masën e sigurisë për ngastrat kadastrale nr. 588/1, nr. 598, nr. 601 dhe nr. 604. Përmes këtij Aktvendimi gjykata caktoi ndalesën e ngarkesës, të vendosjes së hipotekës si dhe të shitjes së ngastrave kadastrale në fjalë, duke theksuar se kjo masë vlen deri në përfundimin e procedurës kontestimore, pranë Gjykatës Komunale C. nr. 414/07

Procedura në Gjykatën Themelore në lidhje me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës që ka të bëjë me vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi ngastrat kadastrale në fjalë

26. Sipas shkresave të lëndës, në bazë të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë (lënda C. nr. 414/07), në muajin korrik 2007, Eksperti i Gjeodezisë A.A., dha konstatimin dhe mendimin e tij me shkrim lidhur me vërtetimin e pronësisë të parashtruesit të kërkesës. Eksperti i Gjeodezisë A.A, theksoi në konstatimin e tij se sipas dokumentacionit valid që disponon Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi në Prishtinë, për Zonën Matiqan*"për ngastrat kadastrale nr. 588/1 plani dhe skica 3/43 vendi i quajtur "Arra e Gavrillit" me kulturë arë kl(5) me S=01.56.45 ha, pastaj ngastra kadastrale nr. 598 plani dhe skica 3/17, vendi i quajtur "Vasinanjiva" me kulturë arë kl (5) me sipërfaqe prej S=01.04.98ha, ngastra Kad, nr.601 plani dhe skica 4/11, vendi i quajtur "Njelmësia" me kulturë arë kl (5) në S=01.03.70 ha, tokë rurale tipi i pronës "shoqërore" evidentohet në: K.B.I "Kosova-Export" me seli në Fushë Kosovë dhe atë në bazë të aeroinçizimit të vitit 1972 e hyrë në fuqi në vitin 1980.*
Para se kjo matje të hyjë në fuqi, në Zonën Kadastrale Matiqan ishte në fuqi kadastri përshkrues, ku nuk disponohej me plane dhe skica detale, në të njëjtën kohë edhe sipërfaqet e ngastrave ishin të llogaritura në mënyrë të përafërt[...].
Eksperti A.A, duke iu referuar numrave të vjetër të ngastrave kadastrale (shih numrat në paragrafin 13 lart), theksoi se: "*është e vështirë saktësisht të vërtetohej se a janë pikërisht këto ngastra që tani janë temë e kësaj lënde, por janë disa elemente karakteristike që përputhen edhe me aeroinçizimin*"

27. Më 17 shtator 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë mbajti seancën sipas kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën që ishte objekt i kontratës së shitblerjes së vitit 1971. Në seancën dëgjimore mori pjesë gjithashtu edhe përfaqësuesi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), i cili e kontestoi juridiksionin e Gjykatës Themelore për t'u marrë me pronën në fjalë, pasi që ajo është e regjistruar si pronë shoqërore dhe si e tillë është nën administrimin e saj.

28. Më 29 dhjetor 2010, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin C. nr. 414/07 me të cilin e shpalli veten jokompetente në procedurën në fjalë, ndërsa parashtruesin e kërkesës e udhëzoi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës si gjykatë kompetente për t'u marrë me çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Procedura në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të Kosovës në lidhje me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi ngastrat në fjalë

29. Më 4 mars 2011 parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke kërkuar vërtetimin e pronësisë në: **I.** Ngastrën kadastrale nr. 588/1, vendi i quajtur "Gavrilova Njiva" me kulturë arë i klasit të 5-të, në sipërfaqe prej 1.56.45 ha; **II.** Ngastrën kadastrale nr. 598, vendi i quajtur "Vasina Njiva" me kulturë arë i klasit të 5-të, në sipërfaqe prej 1.04.98 ha **III.** Ngastrën kadastrale nr. 601, vendi i quajtur "Njelmësina" me kulturë arë i klasit të 5-të, në sipërfaqe prej 0.41.66 ha; si dhe **IV.** Ngastrën kadastrale nr. 604, vendi i quajtur "Njelmësina" me kulturë arë i klasit të 5-të , në sipërfaqe prej 1.03.70 ha, të regjistruara sipas fletëposedimit nr.389, Zona Kadastrale Matiqan. Parashtruesi i kërkesës në padinë e tij, theksoi se çmimin e blerjes e ka paguar në prezencën e dy dëshmitarëve , dhe prej asaj kohe ai ka poseduar dhe shfrytëzuar paluajtshmërinë pa pengesë. Thekson se nuk ka mundur të bëjë bartjen e paluajtshmërisë për shkak të tatimit të lartë të asaj kohe, dhe pretendon se kjo paluajtshmëri pa bazë ligjore është evidentuar në emër të KBI "Kosova-Export".

30. Më 17 nëntor 2011, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS) nxori Aktvendimin SCC-11-0085, për vazhdimin e procedurës gjyqësore. Prandaj, DHPGJS-ja i përcolli AKP-së si palë e paditur kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke i dhënë asaj afat prej 30 ditësh që të përgjigjet në padi.

31. Më 12 dhjetor 2011, AKP e dërgoi përgjigjen e saj në padinë e parashtruesit të kërkesës, në të cilën i mohoi të drejtat e pronësisë së parashtruesit mbi ngastrat kadastrale në fjalë, duke deklaruar në mes tjerash *"se kontrata e tillë nuk është legalizuar në Gjykatë dhe si e tillë nuk i plotëson kushtet ligjore dhe në këtë drejtim nuk mund të pranohet si provë"*. AKP në këtë shkresë gjithashtu theksoi se *"pavarësisht rrethanave se si e paditura është bërë pronare, qoftë edhe pa bazë juridike, AKP e mbështetë mbrojtjen e saj duke iu referuar dispozitës juridike nga Neni 268 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar, ku parashihet decidivisht se po që se patundshmëria ka kaluar në pronësi shoqërore pa bazë juridike, kthimin e së njëjtës mund të kërkohet në afat prej 5 vitesh, duke filluar nga dita e marrjes në dijeni, por më së voni në afat prej 10 vitesh."* AKP gjithashtu deklaroi se në pronën shoqërore pronësia nuk mund të fitohet në bazë të parashkrimit fitues.

32. Më 9 janar 2013, gjyqtari i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar i DHPGJS-ë) nxori Urdhrin SCC-11-0085, përmes të cilit përgjigjen e të paditurës AKP-së, të datës 12 dhjetor 2011, ia dërgoi parashtruesit të kërkesës, duke i dhënë atij një afat prej 15 ditësh që t'i përgjigjet asaj.

33. Më 24 janar 2013, parashtruesi i kërkesës i dërgoi përgjigje Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, ku i deklaronte argumentet e njëjta sikur ato të cekura në kërkesëpadi.

34. Më 5 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës i parashtroi DHPGJS-së kërkesëpadinë e re të precizuar në të cilën deklaronte se "*Në bazë të Aktgjykimit P.nr.645/04 të datës 20.02.2007, atij i janë marrë dy ngastra kadastrale dhe u janë dhënë serbëve (familjes S.) si kompensim, edhe atë ngastra kadastrale nr. 588/1, vendi i quajtur "Gavrillova Njiva", me kulturë Arë, klasa e 5-të, në sipërfaqe prej 1.56.45 ha, dhe ngastra kadastrale nr. 598, vendi i quajtur "Vasina Njiva", me kulture Arë, klasa e 5-të, në sipërfaqe prej 1.04.98 ha, që do të thotë paditësi është dëmtuar në sipërfaqe të përgjithshme prej 2.61.43 ha, për shkak të neglizhencës së ish Gjykatës Komunale në Prishtinë që nxjerr me vonësë aktvendimin mbi Masën e sigurisë, dhe tash për shkak të zvarritjes së procedurës në këtë çështje nga ana e DHPGJS-së"*.

35. Rrjedhimisht, në kërkesëpadinë e precizuar, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së që:

i) *"Të aprovohet kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës dhe të vërtetohet se i njëjti është pronar i ngastrave kadastrale nr.601, vendi i quajtur "Njelmësina", me kulturë Arë, klasa e 5-të, në sipërfaqe prej 0.41.66 ha, dhe ngastrës kadastrale nr.604, vendi i quajtur "Njelmësina", me kulture Arë, klasa e 5-të, në sipërfaqe prej 1.03.70 ha, të cilat evidentohen sipas fletës poseduese nr.389, ZK. Matiçan.*

ii) *Me aktgjykim të obligohet e Paditura KBI "Kosova Export" nga Fushë Kosova që parashtruesit të kërkesës në emër të kompensimit të ngastrave kadastrale nr.588/1, vendi i quajtur "Gavrillova Njiva", me kulture Arë, klasa e 5-të, në sipërfaqe prej 1.56.45 ha dhe ngastrës kadastrale nr. 598, vendi i quajtur "Vasina Njiva", me kulturë Arë, klasa e 5-të, në sipërfaqe prej 1.04.98 ha, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2.61.43 ha, të cilat në mënyrë të kundërligjshme me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë P. nr. 645/04 të datës 20.02.2007 iu kanë dhënë personave të tretë t'i jepen si kompensim ngastrat si në vijim:*

Nr. 523, plani 3, skica 7, në vendin e quajtur "Utrina", kultura kullosë, klasa e 3-të, në sipërfaqe prej 0.38.09 ha
Nr. 524, plani 3, skica 7, në vendin e quajtur "Utrina D. Potok", kultura arë, klasa e 7-të, në sipërfaqe prej 0.62.98 ha
Nr. 525, plani 3, skica 7, u në vendin e quajtur "Utrina D. Potok", kultura kullosë, klasa e 2-të, në sipërfaqe prej 0.10.03 ha
Nr. 526, plani 3, skica 7, në vendin e quajtur "Utrina D. Potok", kultura arë, klasa e 6-të, në sipërfaqe prej 0.21.96 ha,
Nr. 536, plani 3, skica 7, në vendin e quajtur "Utrina Vina Lojze", kultura kullosë, klasa e 3-të, në sipërfaqe prej 1.06.44 ha,
Nr. 552/2, plani 3, skica 9, në vendin e quajtur"Utrina Veternik", kultura arë, klasa e 7-të, në sipërfaqe prej 0.57.60 ha, të cilat gjenden në Zonën Kadastrale në Qagllavicë e të cilat evidentohen në listën poseduese nr. 222".

36. Më 27 korrik 2017, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së mbajti seancën dëgjimore, në të cilën parashtruesi i kërkesës ndër të tjera deklaroi se *"[...] ne nuk kemi kërkuar fitimin e së drejtës së pronës përmes*

parashkrimit fitues, sepse këtë do duhej që dikush tjetër të ketë qenë pronari, në këtë rast KBI[...]. Ne donim ta vërtetonim faktin se prona është regjistruar aksidentalisht në KBI, përderisa paditësi e ka blerë këtë pronë, e ka paguar shumën kontraktuale dhe e ka në posedim prej disa dekadash. Ndërsa, në po këtë seancë, theksoi se e kundërshton padinë në tërësi sepse (i) E paditura KBI "Kosova Eksport" nuk është futur asnjëherë në raport ligjor civil me parashtruesin e kërkesës; (ii) prona e KBI "Kosova Export" nuk është transferur aksidentalisht, kjo bazuar në konkludimet e ekspertit A.A, i arritur në rastin CNR. 414-07, në të cilat është konkluduar se pronat që nga viti 1972 janë të regjistruara në emër të KBI "Kosova Export"; dhe (iii) kontrata e parashtruesit të kërkesës nuk është e lidhur në gjykatë, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë efekte juridike.

37. Më 22 gusht 2017, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, nxori Aktgjykimin SC-11-0085, me të cilin kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës u hodh poshtë si e pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit thuhet:

> *„Paditësi e bazon padinë e tij pronësore në një blerje më anë të një kontrate të shitblerjes të vitit 1971. Është e padiskutueshme që kjo kontratë nuk përputhet me kërkesat formale. Paditësi nuk ka asnjë dëshmi tjetër me të cilën do të mbështeste kërkesën e tij pronësore. Pasi që Paditësi nuk ka arsye tjetër për të mbështetur kërkesën e tij për pronë, padia është e pabazuar. Ai në asnjë moment nuk ka qenë pronar i tokës në fjalë. Prandaj, argumenti i tij se e paditura në mënyrë arbitrare është regjistruar si pronare, është i parëndësishëm".*

38. Më 15 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së në të cilin deklaronte se *"gjykata ka dështuar të ekzaminoj dhe të përcaktojë siç duhet gjendjen faktike, se ai e ka shfrytëzuar pronën e kontestuar pa u penguar nga viti 1971, se pas vitit 1999 ai e ka kuptuar që prona është në emër të Ndërmarrjes Shoqërore, dhe se në vitin 2007 ai ka dorëzuar padinë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për kthimin e pronave."*

39. Më 2 nëntor 2017, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin AC-I-17-0568, përmes të cilit:

> në **pikën I,** e pranoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të bazuar,
> Në **pikën II,** e ndryshoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar SCC-11-0085, të datës 22 gusht 2017,

Në **pikën III,**e pranoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të bazuar, dhe
Në **pikën IV,** konstatoi se paditësi është pronar në lidhje me ngastrat kadastrale nr. 2/257/28, në vendin e quajtur "Gavrilova Njiva", me kulture arë, e klasit të V-të, në sipërfaqe prej 1.56,00 ha; nr. 2/257/37, në vendin e quajtur "Vasina Njiva", me kulturë arë, e klasit të V-të, në sipërfaqe prej 1.05,00ha, nr. 2/257/40 në vendin e quajtur "Slanište", me kulturë arë, e klasit të V-të, në sipërfaqe prej 0.41,00 ha, dhe nr. 2/257/43 në vendin e quajtur "Slanište", me kulturë arë, e klasit të V-të, në sipërfaqe prej 1.03,00 ha, të cilat janë të evidentuara në fletën poseduese nr. 45, ZK Matiqan.

40. Në arsyetimin e Aktgjykimit AC-I-17-0568, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, theksoi:

"Kolegji i Apelit vëren se paditësi padinë e tij pronësore e mbështet në Kontratën mbi shitblerjen e patundshmërisë të lidhur me datë 23.07.1971 në mes tij dhe personit fizik L(Q) N nga Matiqani. Kontrata e shitblerjes i referohet ngastrave të kontestuara. E paditura as nuk e kundërshton ekzistimin e kësaj kontrate me shkrim e as që e vë në pyetje pretendimin e paditësit se menjëherë pasi që kontrata është nënshkruar, prona në fjalë i është dorëzuar atij dhe se ai e posedon atë që atëherë. [...]

Është e saktë se kontrata e shitblerjes në fjalë nuk është vërtëtuar në Gjykatën kompetente. Por kjo nuk ka qenë një kërkesë ligjore në kohën e lidhjes të saj. Në atë kohë, kontrata e shitjes në lidhje me parcelën e kontestuar ishte nënshkruar dhe toka i ishte dorëzuar paditësit, kërkesë e domosdoshme ligjore, për të fituar pronësinë mbi pronën e paluajtshme përmes transkasionit ligjor, ishte dhënë me Ligjin mbi Transaksionet duke përfshirë tokat dhe Ndërtesat(gazeta zyrtare e RSFJ-së nr.43/65). Në lidhje me transaksionet mes qytetarëve, ligji cek vetëm një kërkesë: Kontrata duhet që të jetë më shkrim(neni 9 i Ligjit në fjalë).[...]

Regjistrimi që mungon i transaksionit në të drejtat pronësore nuk e pengoi transferin e të drejtave të pronësisë në vitin 1971 meqë regjistrimi nuk ka qenë një element përbërës i transaksionit të të drejtave pronësore të pronës së paluajtshme gjersa Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (Gazeta zyrtare e RSFJ-së nr.6/80) hyri në fuqi me datë 01 shtator 1980.

Me rastin në fjalë i takon të padituës për të ofruar faktet të mjaftueshme të cilat tregojnë një shkëmbim të vlefshëm të

drejtave të pronës [...]. E paditura[...] duhet qe ta dij se në çfarë bazash ka fituar të drejtën në fjalë[...] "

Kërkesa e parashtruesit të kërkesës për korrigjim të Aktgjykimit AC-I-17-0568 të Dhomës së Apelit të DHPGJS-së, të 2 nëntorit 2017

41. Më 4 dhjetor 2017, avokati i parashtruesit të kërkesës dorëzoi një parashtresë në DHPGJS për korrigjimin e Aktgjykimit AC-I-17-0568 të Kolegjit së Apelit të DHPGJS-së të 2 nëntorit 2017, përmes së cilës kërkonte që:

a) të bëhet korrigjimi i Aktgjykimit AC-I-17-0568 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së në lidhje me numrin e ngastrave kadastrale në vijim: për ngastrën kadastrale nr. 2/257/37, vendi i quajtur "Vasina njiva", me kulturë arë , klasa eV-të, në sipërfaqe prej 1.05.00 ha, kërkon të korrektohet si ngastra kadastrale nr. **604**, vendi i quajtur "Njelmësina", me kulturë arë, në sipërfaqe prej 1.03.70 ha, të evidentuara sipas fletës poseduese nr. 389,ZK Matiqan, ndërsa për ngastrën kadastrale nr. 2/257/40, vendi i quajtur "Sllanishte", me kulturë arë, klasae V-të, në sipërfaqe prej 0.41.00 ha, kërkon të korrektohet si ngastra kadastrale nr. **601**, vendi i quajtur "Njelmësina", me kulturë arë, klasa e V-të, në sipërfaqe prej 0.41.66 ha, të regjistruara sipas fletës poseduese nr. 389, ZK Matiqan.

b) Kolegji i Apelit i DHPGJS-së të nxjerr një aktgjykim plotësues, me të cilin e paditura do të obligohej që parashtruesit të kërkesës në emër të kompensimit të ngastrave kadastrale **nr. 588/1**, vendi i quajtur "Gavrilova Njiva", me kulture arë, klasa e V-të , në sipërfaqe prej 1.56.45 ha dhe ngastrës kadastrale **nr. 598**, vendi i quajtur "Vasina Njiva", me kulturë arë, klasa e V-të, në sipërfaqe prej 1.04.98 ha, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2.61.43 ha, të cilat me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr.645/04 të datës 20.02.2007 u janë dhënë personave të tretë (familjes S.), t'i jepen si kompensim ngastrat kadastrale në vijim:

- nr. **523**, plani 3, skica 7, në vendin e quajtur "Utrina", kultura kullosë, e klasit të 3-të, në sipërfaqe prej 0.32.09 ha
- nr. **524**, plani 3, skica 7, në vendin e quajtur "Utrina D. Potok", kultura arë, e klasit të7-të , në sipërfaqe prej 0.62.98 ha
- nr. **525**, plani 3, skica 7, u në vendin e quajtur "Utrina D. Potok", kultura kullosë, e klasit të2-të, në sipërfaqe prej 0.10.03 ha
- nr. **526**, plani 3, skica 7, në vendin e quajtur "Utrina D. Potok", kultura arë, e klasit të 6-të, në sipërfaqe prej 0.21.96 ha,

- nr. **536**, plani 3, skica 7, në vendin e quajtur "Utrina Vina Lozje", kultura kullosë, e klasit të 3-të, në sipërfaqe prej 1.06.44 ha,
- nr. **552/2**, plani 3, skica 9, në vendin e quajtur "Utrina Veternik", kultura arë, e klasit të 7-të, në sipërfaqe prej 0.57.60 ha, të cilat gjenden në Zonën Kadastrale në Çagllavicë, e të cilat evidentohen në listën poseduese nr. 222.

42. Më 13 dhjetor 2017, Kolegji i Apelit lëshon një urdhër për Avokatin e parashtruesit të kërkesës me të cilin kërkon që në afat prej pesë (5) ditësh, nga data e pranimit të urdhrit, t'i dërgon gjykatës dokumente kadastrale duke përfshirë historinë kadastrale për të vërtetuar pretendimet e paraqitura në parashtresën e dorëzuar të 7 dhjetorit 2017, në lidhje me ndryshimin e numrave të ngastrave kadastrale në fjalë të cekura në pikën IV të Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568, të 2 nëntorit 2017.

43. Më 21 dhjetor 2017, avokati i parashtruesit të kërkesës, parashtroi një kërkesë në Komunën e Prishtinës- Drejtorinë për Kadastër, me të cilën kërkonte që t'i lëshohet dokumenti me shënime, në pajtim me urdhrin e DHPGJS-së të 13 dhjetorit 2017.

44. Më 26 dhjetor 2017, avokati i parashtruesit të kërkesës dorëzoi një parashtresë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, përmes së cilës e informonte atë se ai kishte kërkuar të dhëna nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës sipas urdhrit të gjykatës, por se nuk kishte marrë kurrfarë përgjigje.

45. Më 16 janar 2018, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktvendimin AC-I-17-0568, me të cilin parashtresën e parashtruesit të kërkesës për korrigjim dhe plotësim të Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-I-17-0568 , të 2 nëntorit 2017, e hodhi poshtë si të papranueshme, duke theksuar:

> *"Në bazë të nenit 49 të Shtojcës së LDHP, korrigjimet e gabimeve administrative me kërkesën e palës bëhën në afatin prej 2 javësh pas dorëzimit të Aktgjykimit. Ndërsa në bazë të nenit 50 të Shtojcës së LDHP-së, sipas kërkesës së palës Aktgjykimi plotësohet në afatin prej 15 ditëve pas pranimit të të Aktgjykimit. Në rastin konkret Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 i datës 02.11.2017, është pranuar nga paditësi me datë 17.11.2017, ndërsa afati për korrigjimin dhe plotësimin e tij ka qenë deri më me 04 dhjetor 2017. Kolegji i Apelit vëren se avokati i paditësit parashtresën për korrigjimin dhe plotësimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Kolegjit të Apelit e ka dorëzuar më 05 dhjetor 2017, rrjedhimisht me një ditë vonesë..."*

46. Më 23 janar 2018, Avokati i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi edhe një parashtresë tjetër në DHPGJS me të cilën kërkonte shfuqizimin e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së AC-I-17-0568, të 16 janarit 2018. Në të njëjtën kohë, ai kërkoi që të përsëritet procedura në lidhje me kërkesën e 4 dhjetorit 2017, në lidhje me korrigjimin dhe plotësimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-sëAC-I-17-0568 të 2 nëntorit 2017, sepse parashtresa e tij për korrigjimin dhe plotësimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit është dërguar me postë më 4 dhjetor 2017, në bazë të së cilës mund të konkludohet se ajo ishte dorëzuar brenda afatit.

47. Gjykata konstaton se në periudhën prej 2 shkurtit 2018 deri më 14 mars 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS ndërmori një numër veprimesh procedurale në mënyrë që të identifikonte dhe përcaktonte parcelat e kontestuara, të gjitha këto me qëllim që të merrte një vendim mbi kërkesën e parashtruesit për korrigjim të Aktgjykimit AC-I-17-0568 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 2 nëntorit 2017 në lidhje me numrat e ngastrave kadastrale dhe çështjen e kompensimit të mundshëm.

48. Më 2 shkurt 2018, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së i lëshoi një urdhër Drejtorisë për Kadastër në Prishtinë në të cilin kërkonte nga ajo që brenda afatit prej 5 ditëve, t'i dërgojë gjykatës një histori të ngastrave kadastrale 2/25728, 2/257/37, 2/257/40 dhe 2/257/43, të evidentuara sipas fletës poseduese nr. 45, të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit më 21 korrik 1969.

49. Nga shkresat e lëndës rrjedh se Drejtoria për Kadastër në Prishtinë nuk është përgjigjur brenda afatit të përcaktuar.

50. Më atë rast, më 22 shkurt 2018, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së lëshoi një urdhër të ri për Drejtorinë për Kadastër në Prishtinë, në të cilin kërkonte nga ajo që brenda afatit prej 5 ditësh, t'ia sqarojë gjykatës nëse ngastra kadastrale nr. 2/257/43 është e njëjtë me ngastrën kadastrale nr. 604, dhe nëse ngastra kadastrale nr. 2/257/40 është e njëjtë me ngastrën kadastrale nr. 604, sikur që pretendon paditësi, gjithashtu të sqarojë ne emër të kujt figurojnë ngastrat kadastrale nr. 604 dhe nr. 601 në regjistrat kadastralë.

51. Të njëjtën ditë, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së lëshoi një urdhër për AKP-në, në të cilin kërkonte nga AKP-ja që të japë komentet e veta mbi parashtresën e parashtruesit të kërkesës të 4 dhjetorit 2017, në lidhje me korrigjimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 të 2 nëntorit 2017, si dhe në lidhje me parashtresën e paditësit të

dorëzuar në DHPGJS më 23 janar 2018, me të cilën kërkon shfuqizimin e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 të 16 janarit 2018.

52. Më 2 mars 2018, Agjencia Kadastrale e Kosovës, iu përgjigj Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, duke pohuar se ata kanë shënime nga vitet 1983 deri më 1988, por jo për më herët. Numrat e njësive kadastrale të kadastrit nuk janë numrat e njëjtë kadastralë që ekzistojnë sot në operatin kadastral, dhe për verifikimin dhe krahasimin e numrave duhet pasur dokumentet kadastrale para vitit 1983, të cilat Agjencia Kadastrale e Kosovës nuk i posedon. Tutje, Agjencia Kadastrale në përgjigjen e saj deklaroi se ishte e pamundur të konstatohet nëse bëhet fjalë për pronën e njëjtë me numrat e njësive të cilat janë cekur në urdhrin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, dhe se ngastrat nr. 601/0 dhe 604/0, ZK Matiqan, janë në pronësi të PSH, KBI "Kosova Export", D.P.S. Kosovo Export.

53. Të njëjtën ditë, AKP-ja e dorëzoi një parashtresë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, duke pohuar se nuk ka elemente për korrigjime teknike të Aktgjykimit AC-I-17-0568 siç pretendon parashtruesi i kërkesës. AKP-ja gjithashtu pohon se ngastrat nr. 601 dhe 604, të evidentuara në fletën poseduese nr. 389, ZK Matiqan, as që janë shqyrtuar me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit. Tutje, AKP pohoi se propozimi i paditësit për të nxjerrë Aktgjykim plotësues që e obligon AKP-në që të kompensojë ngastrat kadastrale nr. 588/1 dhe 598 me ngastrat tjera kadastrale, të cilat parashtruesi i kërkesës i ka cekur në parashtresën e tij, nuk është i lejueshëm në bazë të LDHP-së. AKP-ja në parashtresë gjithashtu pohoi se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me AktvendiminAC-I-17-0568 të 16 janarit 2018 e ka hedhur poshtë parashtresën - propozimin e parashtruesit të kërkesës për korrigjim dhe plotësim të aktgjykimit, andaj kjo çështje është vendosur me vendim përfundimtar dhe konsiderohet si çështje e gjykuar.

54. Më 7 mars 2018, avokati i parashtruesit të kërkesës dorëzoi edhe një parashtresë të re në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, në të cilën, ndër të tjera, pohoi "*se ka angazhuar në cilësinë e eskpertit gjeodetin e licencuar për shërbime kadastrale gjeodezike, dhe se sipas ekspertizës së tij ai pohon se ngastra sipas kadastrit përshkrues 2/257/40 është e njëjtë me ngastrën kadastrale sipas kadastrit të tokave, ngastra nr. 601, ndërsa ngastra kadastrale nr. 2/257/43 sipas kadastrit përshkrues është e njëjtë me ngastrën kadastrale sipas kadastrit të tokës nr. 604, që do të thotë se bëhet fjalë për të njëjtën patundshmëri*".

55. Më tej, sa i përket ngastrës nr. 2/257/28 sipas kadastrit përshkrues, avokati i parashtruesit të kërkesës pohon se është e njëjta me ngastrën kadastrale sipas kadastrit të tokës, ngastra nr. 588/1, ndërsa ngastra sipas kadastrit përshkrues 2/257/37 është e njëjtë me ngastrën kadastrale sipas kadastrit të tokave nr. 598. Këto janë ngastrat që i janë dhënë familjes S., dhe për të cilat ata kërkojnë ngastra të tjera dhe nxjerrjen e një aktgjykimi të ri.

56. Më 29 mars 2018, Gjyqtari përgjegjës i lëndës e dorëzon një kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, dedikuar për Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Serbisë, me qëllim të ofrimit të informacioneve relevante kadastrale për fletën poseduese nr. 45, e cila është lëshuar më 21.07.1969, e në lidhje me ngastrat kadastrale: ngastra nr. 2/257/43, vendi i quajtur "Vasina Njiva", me kulturë arë, në sipërfaqe prej 1.03.00 ha dhe ngastra 2/257/40, në vendin e quajtur "Slanište", me kulturë arë, në sipërfaqe prej 00.41.00ha, Zona Kadastrale Matiqan.

57. Më 30 nëntor 2018, Enti Republikan i Gjeodezisë i Republikës së Serbisë i dërgoi një përgjigje Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së. Në parashtresë, Enti Republikan i Gjeodezisë i Republikës së Serbisë pohon se pas kërkimeve tërësore të shënimeve të Komunës Kadastrale Matiqan, ngastrat nr. 2/257/43 dhe nr. 2/257/40, të cilat janë të evidentuara në emër të mbajtësit N.Q.L., ndërsa sipas matjes së re ngastrat mbajnë numrat 601 dhe 604 dhe janë të regjistruara në listën regjistruese 389. Për më tepër, Enti Republikan i Gjeodezisë i Republikës së Serbisë pohon se Dega e Arkivit e Republikës së Serbisë në Beograd - Dega e Prishtinës, me kërkim fizik me dorë, as gjatë skanimit dhe digjitalizimit të dokumenteve për Kosovë, nuk ka gjetur asgjë nga dokumentacioni i kërkuar.

58. Më 20 dhjetor 2018, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktvendimin AC-I-17-0568, përmes së cilit e caktoi ekspertin e gjeodezisë, Sh.P., nga Prishtina që të kryej ekspertizën e kërkuar.

59. Më 21 dhjetor 2018, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së lëshoi një urdhër për AKP-në dhe parashtruesin e kërkesës, në të cilin kërkonte që ata të japin komentet e tyre, nëse kanë, në lidhje me parashtresën e Entit Republikan të Gjeodezisë të Republikës së Serbisë.

60. Më 28 dhjetor 2018, AKP-ja dorëzoi përgjigjen e saj ku deklaronte, *"se nuk e ka të qartë për çfarë arsye i është dorëzuar një një parashtresë e tillë, për një çështje e cila tashmë është mbyllur"*.

61. Parashtruesi i kërkesës nuk u përgjigj në urdhrin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 21 dhjetorit 2018.

62. Më 23 janar 2019, AKP-ja e dorëzoi edhe një parashtresë tjetër në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, me të cilën kërkonte që ai të mos ndërmarrë asnjë veprim procedural në këtë rast pasi që Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 i 2 nëntorit 2017, është bërë i plotfuqishëm, dhe se i njëjti e ka fituar fuqinë e çështjes së gjykuar (*res judicata*).

63. Më 24 janar 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së i dërgoi parashtresën e AKP-së, së 23 janarit 2019, parashtruesit të kërkesës, duke i dhënë atij 7 ditë afat për t'u përgjigjur në te.

64. Avokati i parashtruesit të kërkesës, brenda afatit ligjor, iu përgjigj komenteve të AKP-së, duke deklaruar se Aktvendimi i Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 i 16 janarit 2018 nuk mund të ishte *res judicata*, pasi që ka qenë një lëshim i gjykatës, i cili si i tillë është prishur. Sa i përket pronës lëndore, parashtruesi i kërkesës deklaron se ajo ishte precizuar me parashtresën e paditësit të 5 dhjetorit 2014.

65. Më 4 mars 2019, eksperti i gjeodezisë i caktuar me urdhrin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së e dorëzoi raportin e ekspertizës gjeodezike lidhur me ngastrat lëndore. Në këtë raport eksperti i gjeodezisë konstaton se më 26 janar 2019 ka qenë në terren [...] dhe se sipas dokumentacionit të vlefshëm me të cilin disponon dhe punon Drejtoria për Kadastër, ngastra kontestuese nr. 601-0 dhe nr. 604-0 evidentohen si pronë Shoqërore e K.B.I. "Kosova Eksport" me seli në Fushë Kosovë dhe atë në bazë të ajro-incizimit të vitit 1972, i cili ka hyrë në fuqi më 31.12.1980. [...] në këtë raport, thuhet se ngastra nr. 601-0 është e njëjtë me numrin e ngastrës sipas kadastrit përshkrues nr. 2/257/40, ndërsa ngastra nr. 604-0 është e njëjtë me ngastrën kadastrale sipas kadastrit përshkrues nr. 2/257/43.

66. Më 5 mars 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së lëshoi një urdhër për parashtruesin e kërkesës dhe AKP-në, me të cilin u dha atyre mundësinë të paraqesin komentet e tyre në lidhje me raportin e ekspertizës brenda afatit prej 7 ditësh.

67. Më 12 mars 2019, avokati i paditësit i dorëzoi një parashtresë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së në të cilën deklaronte se nuk kishte vërejtje në lidhje me ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë në pjesën në të cilën objekti i ekspertizës ishte në lidhje me ngastrat nr. 601 dhe nr. 604,

por ka vërejtje për faktin se Kolegji i Apelit e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit, ashtu që kërkesa për korrigjimin e Aktgjykimit ka të bëjë edhe me ngastrat e tjera kadastrale nr. 523, nr. 524, nr. 526 dhe nr. 552/2.

68. Me 13 mars 2019, AKP-ja i dorëzoi një parashtresë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, në të cilën deklaronte: [...] për të identifikuar një parcelë të kadastrit përshkrues dhe për ta krahasuar me numrin e parcelës në kadastrin e matjeve eksperti do të duhej të kishte dy elaboratet, atë përshkrues dhe atë të matjeve (ajro-incizimin stero fotogrametrik). AKP-ja në këtë parashtresë i propozon gjykatës që të mos e merr për bazë konstatimin e tillë të ekspertit dhe propozon një super-ekspertizë ku do të merreshin parasysh vërejtjet e AKP-së dhe sqarimi i lëndës në tërësi.

69. Më 14 mars 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktvendimin AC-I-17-0568 me të cilin vendosi:

I. Kërkesa e paditësit e 23 janarit 2018, për shfuqizimin e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-17-0568 të 16 janarit 2018 është e bazuar.

II. Shfuqizohet Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-sëAC-I-17-0568 i 16 janarit 2018.

III. Aprovohet kërkesa e paditësit për korrigjimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 të 2.11.2017, lidhur me numrat e ngastrave të cekura në pikën IV të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

IV. Korrigjohen në pikën IV të dispozitivit të Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 të 02.11.2017, numri i ngastrave si në vijim: për ngastrën kadastrale nr. 27257/43, numri i saktë i ngastrës duhet të jetë nr. 604 në vendin e quajtur "Njelmësina", me kulturë Arë, e klasit të V, në sipërfaqe prej 1.03,00 ha, e evidentuar sipas fletës poseduese nr.389, ZK Matiqan; ndërsa për ngastrën nr.2/257/40, numri i saktë i ngastrës duhet të jetë nr.601, në vendin e quajtur "Njelmësina", me kulturë Arë, e klasit të V, në sipërfaqe prej 0.41,00 ha, e evidentuar sipas fletës poseduese nr.389, ZK Matiqan. Pjesa tjetër e pikës IV të dispozitivit mbetet e pandryshuar.

V. Kërkesa e paditësit e parashtruar në parashtresën e dorëzuar më4 dhjetor 2017 lidhur me nxjerrjen e Aktgjykimit plotësues dhe njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrat vijuese: nr. 523, në vendin e quajtur "Utrina" në sipërfaqe prej 0.32.09 ha, nr. 524, në vendin e quajtur "Utrina D. Potok" në sipërfaqe prej 0.62.98 ha, nr. 525, në vendin e quajtur "Utrina D. Potok"

në sipërfaqe prej 0.10.03 ha, nr. 526, në vendin e quajtur "Utrina D. Potok" në sipërfaqe prej 0.21.96 ha, nr. 536, në vendin e quajtur "Utrina Vina Lozje" në sipërfaqe prej 1.06.44 ha, nr. 552/2 në vendin e quajtur "Utrina Veternik" në sipërfaqe prej 0.57.60 ha, të cilat gjenden në Zonën Kadastrale në Çagllavicë, të evidentuara në listën poseduese 222, dhe të cilat paditësi i kërkon t'i jepen si kompensim në vend të ngastrave nr. 2/257/28 që ai pohon se sipas kadastrit në fuqi mban nr. 588/1, vendi i quajtur "Gavrilova Njiva" në sipërfaqe prej 1.56.45 ha, dhe ngastrës kadastrale nr.2/257/37 që ai pohon se sipas kadastrit në fuqi mban nr. 598, vendi i quajtur "Vasina Njiva" në sipërfaqe prej 1.04.98 ha, hedhet poshtë si e papranueshme.

70. Për sa i përket **pikës I**, dhe **pikës II** të dispozitivit të Aktvendimit AC-I-17-0568, për shfuqizimin e Vendimit të Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 të 16 janarit 2018, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së deklaroi:

"Kolegji i Apelit ka konstatuar se pohimi i paditësit se kërkesa e tij për korrigjimin dhe plotësimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit është dorëzuar me datë 04.12.2017, është i bazuar, pasi që këtë pohim ai e vërteton edhe me vërtetimin për pranimin e dërgesës në postë, që mban vulën me datë të njëjtë. Për më tepër Kolegji i Apelit vëren poashtu se paditësi parashtresën e tij për korrigjimin dhe plotësimin e Aktgjykimit e ka dërguar përmes postës, pasi që në dosje është plikoja e kësaj dërgese, në të cilën pliko është vula e postës që mban datën 04.12.2017, dhe këtë fakt Kolegji i Apelit nuk e ka vërejtur kur e ka marrë Aktvendimin AC-I-17-0568 të datës 16.01.2018 ".

71. Për sa i përket **pikave III dhe IV** të dispozitivit të Aktvendimit AC-I-17-0568, për korrigjimin dhe plotësimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 të 2 nëntorit 2017, në lidhje me numrat e ngastrave të përmendura, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së konkludoi:

"Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ka shqyrtuar edhe pretendimet e paditësit të dhëna në parashtresën e këtij të fundit e cila është dorëzuar në DHPGJS më datë 12 mars 2019 dhe ato pretendime nuk i ka pranuar si të bazuara.Kolegji i Apelit ka bërë korigjimin e numrit të ngastrave 2/257/43 dhe 2/257/40 që ishin objekt i kontratës së shitblerjes të vitit 1971, në bazë së cilës bazohet Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 të datës 02.11.2017. Kurse për dy ngastrat tjera 2/257/28 dhe 2/257/33 të cilat ishin objekt i kontratës së shitblerjes të vitit 1971, edhe vetë paditësi në parashtresën e tij për korrigjim dhe plotësim të Aktgjykimit

qëështë dorezuar në DHPGJS më datë 04 dhjetor 2017, ka pohuar se në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës C.nr.645/04 të datës 20.02.2007, këto dy ngastra janë në emër të personave privat, dhe në vend të këtyre dy ngastrave ai ka kërkuar kompensim me ngastra tjera, e cila kërkesë për plotësim të Aktgjykimit të datës 02.11.2017, në bazë të arsyeve në vijim hedhet poshtë si e papranueshme."

72. Për sa i përket **pikës V** të dispozitivit të Aktvendimit AC-I-17-0568, për kërkesën për nxjerrjen e aktgjykimit plotësues, me të cilin parashtruesit të kërkesës do t'i jepeshin ngastrat nr. 552/2, nr. 523, nr. 524 nr. 525, nr. 526, nr. 536, si një lloj kompensimi për dy ngastrat kadastrale nr. 588/1 dhe nr. 598, të cilat ngastra, sipas tij, në mënyrë të kundërligjshme i janë marrë atij me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë P. nr. 645/04 të 20 shkurtit 2007, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ka konkluduar:

"Kolegji i Apelit vëren se i ka adresuar pretendimet ankimore të parashtruesit të parashtruara në ankesën e datës 18 shtator 2017 ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar SCC-11-0085 të datës 22.08.2017, andaj lidhur me ankesën e tij tashmë i ka dhënë zgjidhjet e përcaktuara në dispozitivin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 të datës 02.11.2017.
Rrjedhimisht, Kolegji i Apelit vlerëson që nuk ka mbetur ndonjë çështje e pazgjidhur , andaj nuk vlerëson se ka arsye ligjore për nxjerrjen e Aktgjykimit plotësues për të zgjidhur në këtë fazë të procedurës, kërkesat e paditësit për kompensim me ngastra tjera të cekura në parashtresën e datës 04 dhjetor 2017.
Për më tepër në bazë të nenit 10.14, të LDHP-së Aktgjykimet e Kolegjit të Apelit janë përfundimtare ndaj të cilëve nuk ka mundësi të paraqiten mjetet e jashtëzakonshme juridike.
Parashtresa e paditësit e datës 04 dhjetor 2017 lidhur me kërkesën per nxjerrjen e Aktgjykimit plotësues, në këtë fazë të procedurës, nuk mund të trajtohet as si kërkesë për rihapje të procedurës në kuptim të nenit 232 të LPK-së.
Andaj në bazë të këtyre arsyeve, kërkesa e paditësit për nxjerrjen e Aktgjykimit plotësues dhe detyrimin e të padituës që paditësit për ngastrat e humbura, t'ia kompensoj me ngastrat e cekura më lartë, duhet të hedhet poshtë si e papranueshme."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

73. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46

[Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së, si dhe nenet 8, 14 dhe 17 të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut.

74. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ngre pretendime në lidhje me **i)** procedurën gjyqësore në lidhje me kërkesën për vendosjen e masës së sigurisë në pronën në fjalë nga Gjykata Komunale, dhe **ii)** në procedurën gjyqësore ku është zgjidhur objekti i kontestit në lidhje me pronën në fjalë.

75. Në lidhje me procedurën gjyqësore lidhur me vendosjen e masës së sigurisë, parashtruesi i kërkesës pretendon që janë shkelur të drejtat e tij sipas nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së sepse "*përkundër faktit që Gjykata Komunale më 20 shkurt 2007 ka vendosur masën e sigurisë, ndalimin e tjetërsimit të ngastrave në fjalë, nuk është respektuar nga ana e organit të Komunës së Prishtinës, përkatësisht Kadastri dhe me këtë parashtruesit të kërkesës nuk i është ofruar siguri juridike, për shkak se qëllimi i masës së përkohshme është që të ruhet gjendja e pandryshuar e patundshmërisë deri në vendosjen meritore të kërkesëpadisë*".

76. Në kontekstin e asaj që u tha më sipër, parashtruesi i kërkesës shton se Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktvendimin C. nr. 645/04 me të cilin dy ngastrat kadastrale nr. 588 dhe 598, për të cilat ai e ka pasur të drejtën e pronësisë, ia ka ndarë familjes S. Me veprime të tilla, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, atij "*i shkelën të drejtat e tij pronësore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenin 46, si dhe të drejtat pronësore të garantuara nga neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane dhe neni 17 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut*".

77. Sa i përket procedurës gjyqësore në të cilën gjykatat vendosën mbi të drejtat pronësore për pronën në fjalë, parashtruesi i kërkesës pretendon, "*që janë shkelur të drejtat e tij për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së*", me ç'rast si argumente për këtë shkelje ai deklaron se "*Më 5 dhjetor 2014, ai i ka parashtruar DHPGJS-së kërkesëpadinë e precizuar përmes së cilës ka kërkuar që në vend të dy ngastrave kadastrale të cilat i janë dhënë familjes S., atij t'i jepen 6 ngastra të tjera si një lloj kompensimi. Megjithatë atë kërkesëpadi të precizuar Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e ka refuzuar si të pabazuar me Aktgjykimin SC-II-0085, të datës 22 gusht 2017 si të pabazuar, dhe me këtë rast nuk është marrë me këtë padi të precizuar*".

78. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës deklaron se *"Parimi themelor i procedurës civile është parimi i disponueshmërisë së kërkesave dhe në frymën e këtij parimi themelor, neni 2 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, në mënyrë të thjeshtë përcakton se gjykatat në procedurë mund të vendosin brenda kufijve të kërkesave të ngritura nga palët ndërgjyqëse... Gjykatat nuk mund të vendosnin jashtë objektit të kërkesave të parashtruara nga palët ose t'iu njohin palëve të drejta të tjera ose të drejta të ndryshme jashtë disponueshmërisë së tyre dhe jashtë objektit të kërkesave të parashtruara nga palët dhe që ishin objekt i shqyrtimit të kërkesëpadisë, gjë të cilën gjykatat nuk e kanë bërë"*.

79. Më tej, parashtruesi i kërkesës deklaron se "*Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, sipas ankesës të tij, ka nxjerrë Aktgjykimin AC-I-17-0568 të 2 nëntorit 2017, në të cilin në* ***pikën III*** *ka vendosur se padia e parashtruesit të kërkesës ishte e bazuar, pra, vetë fakti se padia është aprovuar si e bazuar në tërësi, atëherë është e qartë dhe e kuptueshme se çfarë është aprovuar nga kërkesëpadia, që do të thotë tërësia e kërkesëpadisë së precizuar së bashku me parashtresën e 5.12.2014, në bazë të cilës mund të konkludohet se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së AC-I-17-0568 i 2 nëntorit 2017 u bë i plotfuqishëm dhe përfundimtar, prandaj si e tillë kjo çështje është RES JUDICATA*".

80. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se Kolegji i Apelit në **pikën IV** të Aktgjykimit AC-I-17-0568 të 2 nëntorit 2017, ka bërë një gabim teknik në lidhje me numrin e ngastrave kadastrale, të cilat si të tilla nuk kanë mundur të jenë të zbatueshme. Në këtë drejtim, në përputhje me nenet 162 dhe 165 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës nr. 03/L-006, ai parashtroi një kërkesë të re në të cilën kërkoi korrigjimin e gabimit teknik, si dhe nxjerrjen e një aktgjykimi të ri në lidhje me kërkesën e precizuar të 5 dhjetorit 2014.

81. Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, në përputhje me kërkesën për korrigjimin e gabimit teknik dhe nxjerrjen e aktgjykimit të ri "*ka vazhduar me zhvillimin e procedurës ligjore sikur kjo padi të ishte një padi e re, dhe kësisoj filloi të paraqesë prova dhe të caktojë ekspertiza sikur kjo çështje të ishte një objekt i ri kontesti, dhe të mos e trajtojë çështjen si RES JUDICATA"*.

82. Parashtruesi i kërkesës konsideron që Kolegji i Apelit i DHPGJS-së duhej të kishte kontrolluar vetëm dispozitivin e pikës IV të Aktgjykimit AC-I-17-0568 dhe ta përpilojë atë në përputhje me objektin e kërkesëpadisë, siç parashihet me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

83. Më tej, parashtruesi i kërkesës konsideron se edhe Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-I-17-0568, me të cilin është miratuar kërkesa për korrigjim është në kundërshtim me kushtetutën, sepse në pikën III të dispozitivit të Aktvendimit, ka vendosur të aprovojë kërkesën e paditësit për korrigjimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 të 2 nëntorit 2017 në lidhje me numrat e ngastrave kadastrale. Megjithatë, në pikën e njëjtë është vendosur vetëm për korrigjimin e dy ngastrave, dhe atë ngastrës me numër 604 dhe ngastrës me numër 601, ndërsa pjesa tjetër e pikës IV të diapozitivit të aktgjykimit mbetet e pandryshuar. Për më tepër, në pikën V të dispozitivit të Aktvendimit të 14 marsit 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së e refuzon në tërësi kërkesën alternative për nxjerrjen e një aktgjykimi plotësues duke mos e shpjeguar arsyen.

84. Parashtruesi i kërkesës pretendon "*se është e qartë se Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-I-17-0568, i 14 marsit 2019, përmban mangësi në lidhje me arsyetimin i cili nuk është shprehur dhe elaboruar mjaftueshëm, duke shkelur kështu nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin KI120/10, Aktgjykimi i 8 marsit 2013 dhe KI71/12, Aktgjykimi i 7 dhjetorit 2012)*".

85. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës konsideron se bazuar në argumentet e sipërpërmendura, Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-17-0568, i 14 marsit 2019, është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, sepse më të shkelet parimi RES JUDICATA.

86. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën:

i) *"që gjykata të konstatojë shkeljen e e parimit RES JUDICATA, të gjejë shkelje të neneve 31 dhe 46 të Kushtetutës, neneve 8 dhe 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut si dhe neneve 6 dhe 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.*

ii) *Të deklarojë pjesërisht të pavlefshme pikën IV të dispozitivit të Vendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së AC-I-17-0568 të 14 marsit 2019, përkatësisht pjesën e pikës IV të dispozitivit e cila mbetet e pandryshuar (pa e ndryshuar pjesën e pikës IV të dispozitivit me të cilën janë korrigjuar ngastrat kadastrale*

nr. 604 dhe 601 si e drejtë e fituar), dhe të deklaroj të pavlefshme pikën V të dispozitivit të vendimeve të sipërpërmendura, dhe të kthej pjesën

iii) e pandryshueshme të dispozitivit IV të vendimit dhe pikën V të të dispozitivit të lartpërmendur, në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës".

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj".

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

Neni 1 i Protokollit 1 (Mbrojtja e pronës)

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cënojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.".

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Aktgjykimi plotësues
Neni 162

162.1 Po që se gjykata nuk ka vendosur mbi të gjitha kërkesat që është dashur të përfshihen me aktgjykim, ose kur vetëm një pjesë e kërkesës ka mbetur pa u përfshirë me të, pala mundet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur i është dorëzuar aktgjykimi t'i propozojë gjykatës që të bëjë plotësimin e tij.
162.2 Po që se pala nuk paraqet propozim për plotësimin e aktgjykimit do të konsiderohet se padia është tërhequr në pjesën që ka mbetur pa u përfshirë me aktgjykimin e dhënë.
162.3 Propozimi i vonuar apo i pathemeltë për plotësimin e aktgjykimit, hidhet poshtë përkatësisht refuzohet nga gjykata pa u caktuar seancë gjyqësore.

Neni 163

163.1 Kur gjykata konstaton se propozimi për plotësimin e aktgjykimit është i themeltë, e cakton seancën për shqyrtim kryesor të çështjes, me qëllim të dhënies së aktgjykimit për pjesën e kërkesës që nuk është zgjidhur (aktgjykimi plotësues).
163.2 Aktgjykimi plotësues mund të jepet edhe pa u hapur përsëri shqyrtimi kryesor, po që se këtë aktgjykim e jep gjyqtari që e ka dhënë aktgjykimin e parë, por pas konstatimit se kërkesa për të cilën propozohet plotësimi është i shqyrtuar mjaftueshëm.
163.3 Në qoftë se propozimi për plotësimin e aktgjykimit ka të bëjë vetëm me shpenzimet e procedurës, aktvendimin mbi propozimin e jep gjykata pa caktuar seancë gjyqësore.

Neni 164

164.1 Në qoftë se, përpos propozimit për plotësimin e aktgjykimit, kundër tij është paraqitur edhe ankesa, ajo nuk e dërgon ankesën në gjykatën e shkallës së dytë derisa të mos merret vendimi mbi propozimin për plotësim, si dhe derisa të mos skadojë afati për goditjen e tij.
164.2 Po që se kundër vendimit mbi plotësimin e aktgjykimit ngrihet ankesa, kjo ankesë së bashku me ankesën kundër aktgjykimit të parë, do t'i dërgohet gjykatës së shkallës së dytë.
164.3 Në qoftë se aktgjykimi goditet me anë të ankesës vetëm nga shkaku se gjykata nuk ka vendosur me të për të gjitha kërkesat e palëve që janë objekt i procesit gjyqësor, ankesa do të konsiderohet si propozim për dhënien e aktgjykimit plotësues.

Korrigjimi i aktgjykimit
Neni 165

165.1 Gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe

mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, i korrigjon gjykata në çdo kohë.
165.2 Korrigjimi i gabimeve bëhet me aktvendim të posaçëm që shkruhet në fund të origjinalit të aktgjykimit, kurse palëve u dërgohet kopja e aktvendimit të tillë.
165.3 Po që se midis origjinalit dhe kopjes së aktgjykimit ekziston mospajtimi në pikëpamje të ndonjë vendimi të përmbajtur në dispozitivin e aktgjykimit, palëve do t'u dërgohet kopja e korrigjuar e aktgjykimit, duke treguar se me këtë kopje të aktgjykimit zëvendësohet kopja e mëparshme e aktgjykimit. Në rast të këtillë afati për ankim kundër pjesës së korrigjuar të aktgjykimit fillon të ecë nga dita e dorëzimit të kopjes së korrigjuar të aktgjykimit.
165.4 Për korrigjimin e aktgjykimit gjykata vendosë pa dëgjimin e palëve.

LIGJI NR. 06/L-086 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 55
Korrigjimi i aktgjykimit

Në rast të gabimeve në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, Dhoma e Posaçme, me nismë të saj apo me kërkesë të paraqitur nga palët, korrigjon aktgjykimin në çdo kohë. Në rast të korrigjimit të aktgjykimit, gjyqtari i vetëm, gjegjësisht kolegji, zbaton mutatis mutandis dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Neni 56
Lëshimet

1. Nëse Dhoma e Posaçme bën lëshim dhe nuk merr vendim për ndonjë pjesë të veçantë së një kërkese apo për shpenzime, cilado palë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të aktgjykimit mund të kërkojë nga Dhoma e Posaçme që ta plotësojë aktgjykimin e saj.

2. Kërkesa për plotësimin e aktgjykimit u dorëzohet palëve kundërshtare dhe gjyqtari i vetëm apo Kryesuesi i Kolegjit e cakton afatin kohor brenda së cilit palët mund të parashtrojnë argumentet kundërshtuese, nëse kanë ndonjë. Pas mbarimit të

afatit kohor të caktuar, Dhoma e Posaçme merr vendim mbi kërkesën.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

87. Duke pasur parasysh që parashtruesi i kërkesës konteston **i)** procedurën gjyqësore të zhvilluar në lidhje me kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, dhe **ii)** procedurën gjyqësore kur është zgjidhur objekti i kontestit në lidhje me pronën në fjalë, ajo duhet të përcaktojë nëse janë plotësuar të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat janë paraparë me Kushtetutë, Ligj dhe të specifikuara më tej në Rregulloren e punës.

88. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

89. Për më tepër, Gjykata gjithashtu u referohet edhe kritereve të pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

„ Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ."

90. Sa i përket përmbushjes së kritereve tjera të pranueshmërisë të cilat i referohen **i)** procedurës së zhvilluar në lidhje me kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht aktvendimin E. nr. 317/07, të Gjykatës Komunale të 16 prillit 2007. Prandaj, Gjykata duhet të përcaktojë nëse kërkesa e parashtruesit është dorëzuar në pajtim me nenin 49 të përmendur të Ligjit, si dhe me Rregulloren 39 (Kriteret e pranueshmërisë) paragrafi (1) c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit.

91. Në lidhje me këtë, sa i përket pretendimeve që kanë të bëjnë me procedurën sipas kërkesës për vendosjen e masës së sigurisë, Gjykata së pari konstaton se këto pretendime kanë të bëjnë me procedurën në Gjykatën Komunale të zhvilluar në vitin 2007. Gjykata gjithashtu konstaton se kjo pjesë e procedurës gjyqësore përfundoi më 29 dhjetor 2010, kur Gjykata Themelore nxori aktvendimin C. nr. 414/07, përmes të cilit u shpall gjykatë jokompetente në procedurën në fjalë, dhe udhëzoi parashtruesin e kërkesës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës si gjykatë kompetente për t'u marrë me çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Me këtë, të gjitha veprimet juridike të ndërmarra nga Gjykata Komunale sipas kësaj kërkese dhe padie kanë pushuar së ekzistuari zyrtarisht.

92. Prandaj, duke pasur parasysh datën e përfundimit të kësaj procedure gjyqësore, e cila është 29 dhjetori 2010, si dhe datën e dorëzimit të kësaj kërkese në Gjykatë, e cila është 17 korriku 2019, Gjykata

konkludon se të gjitha këto pretendime janë jashtë afatit ligjor prej 4 muajve siç parashikohet në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) c) të Rregullores së punës.

93. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe që vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih: *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 25 gushtit 2005; shih, gjithashtu: rasti nr. KI140/13*, Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24).

94. Në lidhje me përmbushjen e kushteve të tjera të pranueshmërisë që kanë të bëjnë me **ii)** procedurën gjyqësore në të cilën është zgjidhur objekti i kontestit në lidhje me pronën në fjalë, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin AC-I-17-0568 e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 14 marsit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me Ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

95. Gjykata më tej konstaton se kërkesa e parashtruesit plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe nuk mund të deklarohet e papranueshme në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39, dhe për këtë arsye duhet ta deklarojë atë të pranueshme dhe t'i shqyrtojë meritat e saj.

Meritat

96. Gjykata rikujton se rrethanat e këtij rasti kanë të bëjnë me vërtetimin e së drejtës pronësore mbi pronën, përkatësisht mbi katër ngastrat në fjalë nr. 2/257/28, nr. 2/257/37, nr. 2/257/40 dhe nr. 2/257/43, të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte blerë më 23 korrik 1971, për të cilën ai lidhi një kontratë për shitblerje me shitësin. Për të ushtruar të drejtën e pronës mbi parcelat në fjalë, parashtruesi i kërkesës paraqiti dy kërkesa në vitin 2007, përkatësisht a) kërkesëpadia për njohjen e

së drejtës pronësore mbi pronën në fjalë, dhe b) kërkesa për vendosjen e masës së sigurisë mbi pronën në fjalë.

97. Megjithatë, duke pasur parasysh që Gjykata tanimë konkludoi se pjesa e kërkesës në lidhje me procedurën e zhvilluar përkitazi me kërkesën për caktimin e masës së sigurisë nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) c) të Rregullores së punës, arrin në përfundimin se në vazhdim do të merret vetëm me meritat e kërkesës në lidhje me procedurën gjyqësore në të cilën janë vërtetuar të drejtat pronësore mbi pronën në fjalë.

Meritat e kërkesës në lidhje me procedurën gjyqësore ku janë vërtetuar të drejtat pronësore të parashtruesit të kërkesës mbi pronën në fjalë

98. Sa i përket meritave në lidhje me procedurën gjyqësore në të cilën ishin vërtetuar të drejtat pronësore mbi pronën në fjalë, Gjykata vëren se më 17 shtator 2010 juridiksioni për të vendosur kontestin juridik në fjalë u transferua nga Gjykata Komunale në DHPGJS. Më 4 mars 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në DHPGJS, duke kërkuar vërtetimin e pronësisë së pronës në fjalë. Gjatë kohëzgjatjes së procedurën në DHPGJS, më 5 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi të plotësuar dhe të specifikuar, përmes të cilës kërkoi që në vend të dy parcelave të ndara tashmë për familjen S, atij t'i ndaheshin 6 parcela të tjera, me numër dhe në sipërfaqe siç kishte deklaruar në kërkesëpadinë e specifikuar.

99. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin SCC-11-0085, duke refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në lidhje me vërtetimin e së drejtës mbi pronën në fjalë të 4 marsit 2011. Në procedurën ankimore, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nxori Aktgjykimin C-I-17-0568, në të cilin i) aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, ii) anuloi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar SCC-11-0085, iii) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të bazuar , dhe iv) përcaktoi që parashtruesi i kërkesës është pronar në lidhje me parcelat kadastrale nr. 2/257/28, nr. 2/257/37, nr. 2/257/40, nr. 2/257/43, të cilat janë regjistruar në fletën poseduese nr. 45, ZK Matiqan.

100. Pikërisht ky fakt ishte problematik për parashtruesin e kërkesës, sepse Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, në pikën iv) të dispozitivit të Aktgjykimit, njohu të drejtën e pronës mbi 4 parcela, të cilat ishin regjistruar sipas sistemit të vjetër kadastral, dhe të cilat në të vërtetë dhe realisht, nuk

mund të regjistroheshin në regjistrat kadastralë si pronë e parashtruesit të kërkesës.

101. Duke pasur parasysh këtë fakt, më 4 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi dy kërkesa në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së.

a) një kërkesë për korrigjim teknik të numrave për dy parcelat në fjalë, në mënyrë që të merret një vendim ku do të renditeshin parcelat në mënyrën dhe nën numrat e sistemit të regjistrave kadastralë të Kosovës, në bazë të të cilit ai do të mund të regjistrohej si pronar,

b) një kërkesë për një nxjerrjen e një aktgjykimi plotësues, në bazë të së cilit atij do t'i ndaheshin 6 parcela të tjera si kompensim, në përputhje me kërkesën e specifikuar të 5 dhjetorit 2014.

102. Duke pasur parasysh bazueshmërinë e kërkesës së parashtruesit të kërkesës, më 14 mars 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktvendimin AC-I-17-0568 me të cilin, i) aprovoi kërkesën e parashtruesit për korrigjim të Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-I-17-0568, ii) aprovoi kërkesën për korrigjimin e numrave të dy parcelave kadastrale në mënyrë të tillë që ngastra kadastrale nr. 2/257/43 të bëhet parcela nr. 604, ndërsa ngastra nr. 2/257/40, bëhet parcela nr. 601.

103. Sa i përket kërkesës për nxjerrjen e një aktgjykimi plotësues, përmes të cilit parashtruesit të kërkesës do t'i ndaheshin parcelat nr. 552/2, nr. 523, Br. 524 nr. 525 nr. 526, nr. 536, si një lloj kompensimi për dy parcela kadastrale nr. 588/1 dhe nr. 598, të cilat, sipas tij, i janë marrë në mënyrë të paligjshme me aktvendim të Gjykatës Komunale P. nr. 645/04 të 20 shkurtit 2007, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së arriti në përfundimin se ajo kërkesë ishte refuzuar, sepse çështja "*në lidhje me këtë kërkesë është zgjidhur me aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së AC-I-17-0568 të 02.11.2017.*

104. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës përballet me situatën,

i) që ka një aktgjykim të plotfuqishëm AC-I-17-0568, të Kolegjit të Apelit të 2 nëntorit 2017, përmes të cilit i njihet e drejta e tij pronësore mbi katër ngastra nr. 2/257/28, nr. 2/257/37, nr. 2/257/40, nr. 2/257/43, të cilat ishin objekt i një kontrate të vitit 1971, dhe të cilën si të tillë nuk mund ta zbatoj;

ii) që më 14 mars 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori një aktvendim të ri AC-I-17-0568, përmes të cilit

bëri korrigjimin teknik, për dy ngastra, nr. 2/257/43 dhe nr. 2/257/40, të cilave u janë dhënë numra të rinj (nr. 588, dhe nr. 598), të cilat u mundësuan atyre të regjistrohen si pronarë në kadastrën e pronave; dhe

iii) që me të njëjtin aktvendim AC-I-17-0568, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së vendosi ta refuzojë kërkesën për kompensim për dy parcelat e tjera 2/257/28 dhe 2/257/37 si të papranueshme me arsyetimin se *aktgjykimi AC-I-17-0568 i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, i 2 nëntorit 2017, ofron zgjidhje të caktuara për këtë çështje*.

Pretendimet në lidhje me procedurën gjyqësore në të cilën gjykatat vendosën për të drejtat pronësore të parashtruesit të kërkesës mbi pronën në fjalë

105. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me vendimet e paarsyetuara gjyqësore, si dhe specifikat e vendimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së (aktgjykimet dhe aktvendimet), në të cilat, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, nuk adresoi në mënyrë specifike të gjitha elementet thelbësore të petitumit të kërkesëpadisë, Gjykata konsideron se kjo pjesë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës të shqyrtohet në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) dhe në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata do të marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me mungesën e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, ku (i) së pari do të shtjellojë parimet e përgjithshme; dhe pastaj do t'i zbatojë të njëjtat në rrethanat e këtij rasti.

106. Gjykata konstaton se pjesa e procedurës gjyqësore në të cilën ishin vërtetuar të drejtat pronësore të parashtruesit të kërkesës përbëhet nga procedura kryesore gjyqësore në të cilën Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin CI-17-0568, si dhe procedurën në lidhje me kërkesën për korrigjim të Aktgjykimit, në të cilën Kolegji i Apelit nxori Aktvendimin C-I-17-0568. Pikërisht për parashtruesin e kërkesës, marrëdhënia midis dispozitivit dhe arsyetimit midis këtyre dy vendimeve gjyqësore është problematike, të cilat sipas tij nuk janë në pajtim me parimet, dhe nuk përmbushin parimet dhe kriteret në lidhje me vendimet e arsyetuara gjyqësore, me çka atij i shkelen e drejtat e garantuara me nenin 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe ato nga neni 46 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

107. Duke pasur parasysh këtë, në vazhdim Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke marrë parasysh si praktikën e saj gjyqësore dhe ashtu edhe atë të GJEDNJ-së në lidhje me vendimet e paarsyetuara gjyqësore.

(ii) Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor

108. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë, por duke mos u kufizuar, në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë,* Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës,* Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Përveç kësaj, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI22/16, me parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, me parashtrues *"IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, me parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët,* Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu,* Aktgjykim i 27 majit 2019; dhe KI35/18, me parashtrues "*Bayerische Versicherungsverbrand*", cituar më lart, dhe KI227/19, parashtrues: *N.T. "Spahia Petrol",* cituar më lart, paragrafi 45).

109. Në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; gjithashtu për më shumë detaje në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, shih, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së të 30 prillit 2020, E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil), IV. Kërkesat Procedurale, 7. Arsyetimet e Vendimeve Gjyqësore, paragrafët 369 deri 380 dhe referencat e përdoruara aty). Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar me të vërtetë, dhe për pasojë kontribuon në një

pranueshmëri më të madhe të vendimeve (shih, rastin e GJEDNJ-së *Magnin kundër Francës*, Vendim i 10 majit 2012, paragrafi 29). Kjo praktikë gjyqësore gjithashtu përcakton se përkundër faktit që një gjykatë ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë aktivitetet dhe vendimmarrjen e saj duke dhënë arsyet përkatëse (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Suominen kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 36; *Carmel Saliba kundër Maltës*, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73, dhe shih rastin e Gjykatës: KI227/19, parashtrues: *N.T. „Spahia Petrol"*, cituar më lart, paragrafi 46). Përveç kësaj, vendimet duhet të jenë të arsyetuara në atë mënyrë që t'u mundësojë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih: rastin e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 30).

110. Në lidhje me këtë përderisa neni 6 i KEDNJ-së i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 61; *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, Vendim i 29 gushtit 2000; dhe *Perez kundër Francës*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81; dhe, dhe shih rastin e Gjykatës: KI227/19, parashtrues: *N.T. „Spahia Petrol"*, cituar më lart, paragrafi 47). Masa në të cilën zbatohet ky detyrim mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të secilit rast. (Shih, rastet e GJEDNJ-së, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 27, dhe shih rastin e Gjykatës: KI227/19, parashtrues: *N.T. „Spahia Petrol"*, cituar më lart, paragrafi 47). Për shembull, një gjykatë apeli, mundet, në parim, të refuzojë një ankesë duke miratuar arsyet e vendimit të gjykatës më të ulët, megjithatë edhe një vendim i tillë duhet të përmbajë mjaftueshëm arsyetim për të treguar se gjykata përkatëse nuk ka miratuar konstatimet e arritura nga një gjykatë më e ulët pa shqyrtim të mjaftueshëm. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Tatishvili kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 62; dhe, shih: gjithashtu rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues: *N.T. „Spahia Petrol"*, cituar më lart, paragrafi 47).

111. Megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nga gjykatat kërkohet që të shqyrtojnë dhe japin përgjigje specifike dhe të qarta në lidhje me: (i) pretendimet dhe argumentet thelbësore të palës (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Donadze kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykim i 3 marsit 2006, paragrafi 35); (ii) pretendimet dhe argumentet që janë

vendimtare për rezultatin e procedurës (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 30; dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28); ose (iii) pretendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih: rastin e GJEDNJ-së, *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96 dhe referencat e përdoruara aty; dhe, shih: gjithashtu rastin e Gjykatës, KI227/19, parashtrues: *N.T. „Spahia Petrol"*, cituar më lart, paragrafi 48).

(ii) Zbatimi i këtyre parimeve në rrethanat e këtij rasti

112. Gjykata së pari rikujton që parashtruesi i kërkesës, duke pasur parasysh që juridiksioni për të vendosur mbi kërkesën e tij i kaloi DHPGJS-së, më 4 mars 2011, parashtroi kërkesë në DHPGJS, duke kërkuar vërtetimin e pronësisë mbi katër parcela kadastrale. Më 5 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës gjithashtu parashtroi kërkesë të specifikuar në DHPGJS për të ushtruar të drejtat e tij sipas kontratës së shitblerjes të vitit 1971.

113. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata konstaton se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së në rastin konkret nxori dy vendime, përkatësisht Aktgjykimin C-I-17-0568, si dhe Aktvendimin C-I-17-0568 për korrigjimin teknik të aktgjykimit në fjalë.

114. Prandaj, Gjykata konsideron se ajo para saj ka dy vendime gjyqësore, analiza e të cilave duhet të përcaktojë nëse ato përmbushin standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, përkatësisht nëse ato pasqyrojnë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ose petitumin e saj, dhe në pajtim me këtë, nëse arsyetohen mjaftueshëm siç përcaktohet në parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, siç janë shtjelluar më lart.

115. Gjykata gjen se petitumi i kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës të 4 marsit 2011 ishte vërtetimi i pronësisë mbi 4 ngastra të cilat ishin shënuar si **I.** Parcela kadastrale nr. 588/1, në vendin e quajtur "Gavrilove njive" me kulturë arë e klasës së 5-të në sipërfaqe prej 1.56.45 ha; **II.** Parcela kadastrale nr. 598, në vendin e quajtur "Vasina njiva" me kulturë arë e klasës së 5-të në sipërfaqe prej 1.04.98 ha; **III.** Ngastra kadastrale nr. 601, një vendin e quajtur "Slanište" me kulturë arë e klasës së 5-të në një sipërfaqe prej 0.41.66 ha; si dhe **IV.** Ngastra kadastrale nr. 604, në vendin e quajtur "Slanište" me kulturë arë e klasës së 5-të në sipërfaqe prej 1.30.70 ha, regjistruar sipas fletës poseduese nr. 389, Zona Kadastrale Matiqan.

116. Gjykata gjithashtu vëren që parashtruesi i kërkesës, më 5 dhjetor 2014, plotësoi petitumin e tij me një kërkesëpadi të specifikuar, në të cilën ai theksoi se ngastrat e tokës 1. nr. 2/257/28, 2. 2/257/37, 3. nr. 2/257/40, 4. nr. 2/257/43, morën numrat e rinj si më poshtë: 1. nr. 581/1, 2. nr. 598, 3. nr. 601, 4. nr. 604. Në lidhje me këtë, ai kërkoi që të vërtetohet se ai është pronar i parcelave të tokës: 1. nr. 602, 2. nr. 604. Përveç kësaj, të detyrohet KBI "Kosova Export" që në emër të kompensimit të parcelave të tokës: 1. nr. 588, 2. nr. 598, të cilat iu ndanë familjes S, atij t'i ndahen 6 ngastra të tjera kadastrale, përkatësisht: 523, 524, 525, 526, 536, 552/2, në të njëjtën sipërfaqe me ato dy ngastra që iu ndanë familjes S.

117. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se petitumi i kërkesëpadisë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së ishte njohja e së drejtës së pronësisë mbi dy ngastrat 1. nr. 602, 2. nr. 604, si dhe çështja e kompensimit të mundshëm për dy ngastra që iu dhanë familjes së S me aktvendim të Gjykatës Komunale nga viti 2007.

118. Gjykata rikujton që gjykatat janë të detyruara të vendosin për kërkesat në fjalë, përkatësisht petitumin e padisë në pajtim me kërkesat e palëve, duke u kujdesur në çdo kohë që juridiksioni i tyre të mbahet brenda atyre kufijve. Kjo zgjidhje ligjore parashihet me nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-006, për Procedurën Kontestimore, në të cilën thuhet,

> "*Neni 2*
> *2.1 Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse*".

119. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata konstaton se më 2 nëntor 2017, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin AC-I-17-0568, në të cilin vendosi që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është e bazuar, ndërsa në paragrafin IV të dispozitivit të aktgjykimit konkludon; "*se paditësi është pronar në lidhje me ngastrat kadastrale nr. 2/257/28, në vendin e quajtur "Gavrilova Njiva", me kulture arë, e klasit të V-të, në sipërfaqe prej 1.56,00 ha; nr. 2/257/37, në vendin e quajtur "Vasina Njiva", me kulturë arë, e klasit të V-të, në sipërfaqe prej 1.05,00 ha, nr. 2/257/40 në vendin e quajtur "Slanište", me kulturë arë, e klasit të V-të, në sipërfaqe prej 0.41,00 ha, dhe nr. 2/257/43 në vendin e quajtur "Slanište", me kulturë arë, e klasit të V-të, në sipërfaqe prej 1.03,00 ha, të cilat janë të evidentuara në fletën poseduese nr. 45, ZK Matiqan*".

120. Gjykata, duke marrë parasysh petitumin e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, si dhe Aktgjykimin AC-I-17-0568 e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, konstaton se ekziston një mospërputhje. Më

konkretisht, gjykata konstaton se parashtruesi parashtroi kërkesëpadinë duke theksuar numrat e parcelave kadastrale, sç janë regjistruar në sistemin aktual kadastral, ndërsa Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori aktgjykimin, me të cilin parashtruesit të kërkesës i njihet e drejta pronësore mbi 4 ngastra, duke përmendur numrat e parcelave kadastrale, mënyrën dhe numrat siç ishin specifikuar në kontratën e shitblerjes së vitit 1971.

121. Prandaj, për Gjykatën nuk është kontestues fakti që përmes Aktgjykimit AC-I-17-0568 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, parashtruesit të kërkesës iu njohën disa të drejta mbi 4 parcelat në fjalë. Po kështu, Gjykata nuk e konteston faktin se Aktgjykimi AC-I-17-0568 i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së është në vetvete i pazbatueshëm, duke pasur parasysh se në Aktgjykim renditen parcelat kadastrale nga marrëveshja e shitblerjes së vitit 1971, të cilat si të tilla nuk mund të regjistrohen në kadastrën ekzistuese të regjistrave të pronës, për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur ndërkohë në lidhje me metodën e shënjimit dhe regjistrimit të parcelave.

122. Më tej, Gjykata gjithashtu konstaton se Aktgjykimi AC-I-17-0568 i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së i 2 nëntorit 2017 nuk shtjellon petitumin e parashtruesit të kërkesës as për çështjen e kërkesëpadisë së specifikuar të 5 dhjetorit 2014, në të cilin, përkujtojmë, parashtruesi i kërkesës kërkoi kompensim për dy ngastra të cilat iu ndanë familjes S. me aktvendim të Gjykatës Komunale.

123. Duke ndjekur rrjedhën e mëtejshme të rrugës procedurale të këtij rasti, Gjykata konstaton se me qëllim të realizimit të të drejtave pronësore, më 5 shkurt 2019 parashtruesi i kërkesës parashtroi dy kërkesa në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568. Një kërkesë i referohej korrigjimit të aktgjykimit, përkatësisht korrigjimit të pikës IV të dispozitivit të aktgjykimit AC-I-17-0568. Me kërkesën e dytë, parashtruesi i kërkesës kërkoi që Kolegji i Apelit i DHPGJS-së të nxjerrë një aktgjykim plotësues në lidhje me kompensim siç specifikohet në padinë e 5 dhjetorit 2014.

124. Gjykata konstaton se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 14 mars 2019, nxori aktvendim të ri AC-I-17-0568, me të cilin aprovoi kërkesën e parashtruesit për korrigjimin e pikës IV të dispozitivit të Aktgjykimit AC-I-17 -0568 të 2 nëntorit 2017, në lidhje me numrat kadastralë për dy parcela, duke deklaruar *„për ngastrën kadastrale nr. 27257/43, numri i saktë i ngastrës duhet të jetë nr. 604 në vendin e quajtur "Njelmësina", me kulturë Arë, e klasit të V, në sipërfaqe prej 1.03,00 ha, e evidentuar sipas fletës poseduese nr. 389, ZK Matiqan; ndërsa*

për ngastrën nr. 2/257/40, numri i saktë i ngastrës duhet të jetë nr. 601, në vendin e quajtur "Njelmësina", me kulturë Arë, e klasit të V, në sipërfaqe prej 0.41,00 ha, e evidentuar sipas fletës poseduese nr. 389, ZK Matiqan".

125. Megjithatë, Gjykata konstaton se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së kërkesën e parashtruesit për nxjerrje të një aktgjykimi plotësues, me të cilin parashtruesit të kërkesës do t'i ndaheshin parcelat nr. 552/2, nr. 523, nr. 524 nr. 525 nr. 526, nr. 536, si një lloj kompensimi për dy parcelat kadastrale nr. 588/1 dhe nr. 598, të cilat, sipas tij, i janë marrë në mënyrë të paligjshme me aktvendimin e Gjykatës Komunale P. nr. 645/04 të 20 shkurtit 2007, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, në pikën V të dispozitivit të aktvendimit, e hodhi poshtë si të pabazuar, duke deklaruar, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së konkludoi: *"lidhur me ankesën e tij tashmë i ka dhënë zgjidhjet e përcaktuara në dispozitivin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit AC-I-17-0568 të datës 02.11.2017"*.

126. Duke pasur parasysh një aktvendim të tillë të Kolegjit të Apelit në kërkesën për korrigjim të Aktgjykimit, Gjykata ka përshtypjen se vetë arsyetimit në një pjesë i mungon qartësia, saktësisht në lidhje me faktet vendimtare që do të kontribuonin që parashtruesi i kërkesës të kuptojë thelbin e të drejtave të tij.

127. Më konkretisht, Gjykata nuk e konsideron problematike pjesën e aktvendimit AC-I-17-0568 që ka të bëjë me korrigjimin e aktgjykimit të 2 nëntorit 2017, në lidhje me pikën IV të dispozitivit, sepse përmes tij përcaktohen dy parcela në në të njëjtën mënyrë siç përshkruhet me sistemin aktual të shënjimit të parcelave kadastrale, që siguron një mundësi që parashtruesi i kërkesës të ushtrojë të drejtat e tij pronësore mbi dy nga katër parcela duke i regjistruar në kadastër, të cilat iu ndanë atij me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së së 2 dhjetorit 2017.

128. Megjithatë, Gjykata kishte vështirësi të konsiderueshme për të kuptuar thelbin dhe logjikën e shpjegimit të pikës V të dispozitivit të aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 14 marsit 2019, për shkak të faktit se Kolegji i Apelit i DHPGJS-ja hedh poshtë kërkesën për një aktgjykim plotësues në lidhje me kompensim për shkak që Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, me aktgjykimin e 2 dhjetorit 2017, *tashmë kishte ofruar zgjidhje për pronën në fjalë* siç thuhet në aktgjykim. Megjithatë, Gjykata sapo konstatoi që Aktgjykimi AC-I-17-0568 i 2 nëntorit 2017, në tërësinë e tij është i pazbatueshëm, duke pasur parasysh se në aktgjykim parcelat renditen me numra joekzistues kadastralë që nuk korrespondojnë me sistemin aktual kadastral.

129. Gjykata është e mendimit se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, në një pjesë të aktvendimit të tij të 14 marsit 2019, humbi mundësinë për të shpjeguar qartë çështjet e rëndësishme të ngritura nga parashtruesi në kërkesën për korrigjimin teknik të Aktgjykimit AC-I -17-0568 të 2 nëntorit 2017, duke krijuar një situatë që vetë aktgjykimi nuk mund të jetë i ekzekutueshëm në kuptimin formal.

130. Me çka Gjykata mund të pajtohet, dhe kjo është, se një pjesë e Aktgjykimit AC-I-17-0568 të 2 nëntorit 2017, u bë i plotfuqishëm, pas nxjerrjes së Aktvendimit AC-I-17-0568 të 14 marsit 2019, i cili jep aktgjykimit të 2 nëntorit 2017 karakterin e plotfuqishmërisë, por vetëm në pjesën në të cilën është bërë korrigjimi i parcelave kadastrale nr. 27257/43, e cila bëhet parcela nr. 604, ndërsa parcela nr. 2/257/40, me korrigjim bëhet parcela nr. 601. me të cilin parashtruesi i kërkesës u bë pronar në kuptimin juridik.

131. Megjithatë, për sa i përket çështjes së parcelës nr. 2/257/28, dhe parcelës nr. 2/257/37, për të cilat përmes Aktgjykimit AC-I-17-0568 të 2 nëntorit 2017, parashtruesit të kërkesës gjithashtu i është njohur e drejta pronësore, si dhe çështja e kompensimit të mundshëm, Gjykata është e mendimit që me qëllim të përcaktimit të fushës së plotë të së drejtës, gjykatës kompetente duhet t'i jepet mundësia të sqarohet për këtë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat që u krijuan pas nxjerrjes së aktvendimit AC-I-17-0568 për korrigjim të 14 marsit 2019. Gjykata gjithashtu shton se nuk është në interesin e palëve në procedurë ose gjykatave kompetente të marrin vendime që nuk mund të kenë efekt juridik lidhur me rezultatin e procedurës, dhe kështu të jenë të pazbatueshme për të drejtat dhe detyrimet e palëve.

132. Prandaj, Gjykata është e mendimit se aktvendimi i 14 marsit 2019 për korrigjimin e aktgjykimit të 2 nëntorit 2017 nuk përmban shpjegimin e nevojshëm për të sqaruar çështjen e të drejtave pronësore të parashtruesit të kërkesës në lidhje me dy parcelat kadastrale ose një kompensimi të mundshëm. Më konkretisht, me arsyetime të tilla në aktgjykim dhe aktvendim, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ngre dyshime të arsyeshme tek parashtruesi i kërkesës për të bërë pyetje, cili është statusi i dy parcelave gjithashtu të ndara atij me Aktgjykimin e 2 nëntorit 2017, përkatësisht nëse ai i ka të drejtat që i janë dhënë atij përmes aktgjykimit, dhe nëse i ka si do t'i realizojë ato, nëse nuk i ka pse nuk i ka ato, ose nëse ai ka të drejtë të kompensimit në mënyrën që ai kërkoi përmes kërkesëpadisë së specifikuar të 5 dhjetorit 2014.

133. Gjykata duke mos paragjykuar rezultatin e procedurës në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së në lidhje me pronën në fjalë mbi dy parcelat nr.

2/257/28, dhe nr. 2/257/37, dhe pa hyrë në pretendimet e tjera ankimore të parashtruesit të kërkesës, konsideron që aktvendimi për korrigjim i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, i 14 marsit 2019, duhet të anulohet vetëm në pjesën e pikës V të pjesës operative të aktvendimit përmes të cilit refuzohet kërkesa për nxjerrje të aktgjykimit plotësues. Ta kthejë atë pjesë të pikës V të aktvendimit në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, i cili do të shpjegojë dhe arsyetojë në mënyrë logjike dhe të vlefshme kërkesën e parashtruesit, si në lidhje me dy parcelat në fjalë, po ashtu edhe për çështjen e të drejtës së kompensimit në pajtim me petitumin e kërkesës, në mënyrën dhe në masën që do të plotësojë kërkesat e një vendimi të arsyetuar gjyqësor në pajtim me standardin dhe parimet e Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së.

134. Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përsërit se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, brenda kuptimit të një vendimi të arsyetuar gjyqësor, i detyron gjykatat të arsyetojnë (i) argumentet thelbësore dhe argumentet e një pale; (ii) pretendimet edhe argumentet të cilat mund të jenë vendimtare për rezultatin e procedurës; ose (iii) pretendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

135. Në rrethanat e rastit konkret, pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e mundshme të të drejtave kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, në lidhje me aktgjykimin e paarsyetuar, janë pretendime thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe si të tilla e ngarkojnë gjykatën përkatëse, në këtë rast Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, që të arsyetojë çështjet e rëndësishme në lidhje me të drejtat pronësore.

136. Gjykata gjithashtu thekson që gjatë vlerësimit të vendimit të gjykatës më të ulët, gjykata më e lartë është gjithashtu e detyruar të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, dhe jo vetëm të vlerësojë nëse gjykata e ulët ka vlerësuar në mënyrë të drejtë ankesën përkatëse përpara saj. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu thekson se qëllimi kryesor i një vendimi të arsyetuar gjyqësor është t'u tregojë palëve se çështja e tyre është dëgjuar me të vërtetë, duke rezultuar në pranueshmëri më të madhe të vendimeve gjyqësore. Në këtë aspekt, nuk është domosdoshmërisht relevante nëse pretendimet e palëve janë meritore për rastin në shqyrtim para gjykatës. Në varësi të natyrës së rastit para saj, gjykata përkatëse është e detyruar të zgjidhë të paktën ato pretendime që janë thelbësore ose vendimtare për meritat e rastit.

137. Heshtja e gjykatave në lidhje me pretendimet e rëndësishme të parashtruesve të kërkesës është shqyrtuar posaçërisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Për shembull në rastet, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, cituar më lart, dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, GJEDNJ përkundër parimeve të përgjithshme të së drejtës për një vendim të arsyetuar të gjykatës adresoi gjithashtu situatat në të cilat gjykatat përkatëse nuk kanë arritur të adresojnë argumentet thelbësore të cilat GJEDNJ i konsideroi vendimtare. Në të dyja rastet, GJEDNJ shqyrtoi nëse heshtja e gjykatës përkatëse mund të interpretohet në mënyrë të arsyeshme si një refuzim i nënkuptuar i refuzimit të argumenteve të palëve (shih: rastin e GJEDNJ-së, *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28). Megjithatë, në mungesë të arsyetimit përkatës, GJEDNJ pohoi se është e pamundur të konstatohet nëse gjykatat përkatëse thjesht neglizhuan të merren me pretendimet përkatëse apo nëse kishin nënkuptuar refuzimin e tyre, nëse ky ishte qëllimi i tyre, cilat ishin arsyet për një qasje të tillë (shih: rastet e GJEDNJ-së *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28; *Ruiy Torija kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafët 29 dhe 30). Në të dyja rastet, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

138. Në rrethanat e këtij rasti, duke marrë parasysh që Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nuk arriti të zgjidhë dhe të arsyetojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës në aktgjykim dhe as në aktvendim, të cilat parashtruesi i kërkesës i deklaroi vazhdimisht në kërkesëpadi, në kërkesëpadinë e specifikuar si dhe në kërkesën për korrigjim teknik të aktgjykimit të 2 nëntorit 2017, krijon paqartësi në lidhje me rezultatin e kërkesëpadisë për njohjen e të drejtave pronësore. Vendime të tilla gjyqësore nuk mund të jenë në përputhje me standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, siç përcaktohet në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së.

139. Prandaj, duke marrë parasysh shqyrtimet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konsideron që një pjesë e arsyetimit në pikën V të dispozitivit të Aktvendimit AC-I-17-0568 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, të 14 marsit 2019, në lidhje me kompensimin, si dhe një pjesë të Aktgjykimit AC-I-17-0568 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 2 nëntorit 2017, gjithashtu në pjesën që lidhet me çështjen e kompensimit, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave të parashtruesit të kërkesës për një vendim gjyqësor të arsyetuar, si pjesë integrale e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

140. Në fund, Gjykata gjithashtu thekson që, pasi tashmë ka konstatuar se një pjesë e aktvendimit dhe një pjesë e aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës të arsyetimit, ajo konsideron se nuk është e nevojshme t'i shqyrtojë pretendimet tjera të parashtruesit të kërkesës. Kolegji i Apelit i DHPGJS-së duhet të shqyrtojë pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës gjatë shqyrtimit të pjesës së aktvendimit dhe pjesës së Aktgjykimit në lidhje me çështjen e kompensimit për dy parcelat nr. 2/257/28, dhe nr. 2/257/37. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu thekson se konstatimi i saj i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e këtij rasti, lidhet ekskluzivisht me mungesën e arsyetimit të vendimit gjyqësor, siç shpjegohet në këtë aktgjykim, dhe në asnjë mënyrë nuk ka të bëjë me dhe nuk prejudikon rezultatin e meritave të rastit.

Përfundimet

141. Gjykata ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke zbatuar në atë vlerësim praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, në lidhje me mungesën e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, garancinë e parashikuar në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së .

142. Gjatë këtij vlerësimi, Gjykata konstatoi se, me nxjerrjen e Aktgjykimit AC-I-17-0568 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 2 nëntorit 2017, si dhe Aktvendimin AC-I-17-0568 të 14 marsit 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nuk arriti të arsyetojë në detaje pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës në lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen dhe rezultatin e procedurës lidhur me çështjen e i) kërkesëpadisë për pronën në fjalë jo në tërësi, por vetëm pjesërisht, ii) çështjen e kompensimit të mundshëm, si një kërkesë alternative.

143. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata, ndër të tjera, ka theksuar faktin se gjykatat janë të detyruara të deklarojnë arsyet për pretendimet e palëve të cilat janë relevante ose mund të jenë vendimtare për meritat e rastit. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata, bazuar në të gjitha shpjegimet e dhëna në këtë aktgjykim, konsideron se ky nuk është një rast i tillë.

144. Prandaj, Gjykata konstaton se një pjesë e aktgjykimit të mësipërm të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së dhe një pjesë e aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së nuk janë në pajtim me garancitë e përfshira në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe, prandaj, duhet të

deklarohen të pavlefshme dhe të kthehen për rishqyrtim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së në mënyrën dhe në pjesën, siç përcaktohet në këtë Aktgjykim.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 nëntor 2021:

VENDOS

I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. TË SHPALLË, me shumicë votash, të pavlefshme pikën V të dispozitivit të Aktvendimit AC-I-17-0568 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 14 marsit 2019;

IV. TA KTHEJË, me shumicë votash, Aktvendimin AC-I-17-0568 e Kolegjit të Apelit të DHPGJS të 14 marsit 2019, për rishqyrtim në lidhje me pikën V të dispozitivit në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TA URDHËROJË Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së që, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, ta njoftojë Gjykatën Kushtetuese sa më parë e më së largu brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh, respektivisht deri më 25 maj 2022, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate;

VI. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të këtij urdhri;

VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Gresa Caka Nimani

INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE

TERMAT		NUMRI I FAQEVE
	A	
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)		252, 258, 260, 261, 272, 273, 274, 279, 284, 287, 294, 298, 299, 308, 309, 314, 319, 322, 474, 475, 476, 477, 478, 487, 493, 497, 499, 500, 605, 621, 624, 625, 630, 687, 688, 689, 690, 692, 693, 700, 701, 704, 707, 708, 1002, 1003, 1004, 1005, 1008, 1009, 1010, 1011, 1097, 1099, 1104, 1124, 1125, 1128, 1167, 1470, 1471, 1477, 1478, 1479, 1480, 1693, 1694, 1700, 1701, 1702, 1703, 1074
Agjencia e Regjistrimit Civil		
Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese		18, 93, 179, 255, 296, 331, 359, 417, 472, 541, 573, 623, 655, 685, 751, 796, 826, 855, 887, 923, 1015, 1096, 1147, 1160, 1179, 1210, 1271, 1308, 1387, 1541, 1571, 1598, 1647, 1688
Aktvendim për Papranueshmëri		41, 44, 79, 218, 219, 221, 345, 398, 401, 402, 403, 408, 428, 461, 507, 509, 514, 529, 530, 557, 563, 566, 567, 597, 599, 612, 618, 641, 642, 671, 673, 714, 734, 738, 766, 767, 776, 834, 838, 846, 870, 901, 904, 913, 918, 937, 953, 956, 971, 980, 982, 991, 995, 996, 998, 1000, 1005, 1006, 1009, 1012, 1041, 1044, 1075, 1076, 1078, 1083, 1084, 1086, 1087, 1090, 1091, 1135, 1144, 1199, 1202, 1206, 1246, 1248, 1258, 1262, 1264, 1267, 1290, 1294, 1299, 1355, 1359, 1360, 1363, 1365, 1376, 1379, 1382, 1383, 1398, 1401, 1410, 1412, 1431, 1433, 1438, 1456, 1457, 1459, 1461, 1463, 1483, 1495, 1511, 1515, 1515, 1521, 1531, 1533, 1659, 1716, 1720

Amendament i propozuar kushtetues		
Autoritete(t) publike		34, 37, 41, 42, 52, 79, 195, 200, 205, 206, 207, 208, 225, 245, 270, 307, 341, 379, 380, 395, 399, 406, 438, 461, 468, 484, 485, 525, 557, 596, 597, 628, 629, 648, 649, 670, 671, 693, 694, 730, 731, 766, 795, 812, 821, 833, 834, 870, 900, 936, 937, 989, 1006, 1029, 1037, 1073, 1074, 1106, 1110, 1143, 1198, 1199, 1256, 1290, 1291, 1330, 1345, 1374, 1375, 1397, 1425, 1426, 1448, 1482, 1484, 1507, 1508, 1530, 1551, 1558, 1564, 1581, 1625, 1714
Avokati i Popullit		221, 234, 419, 429, 430, 431, 432, 437, 965, 1667, 1670
	B	
Barazia para Ligjit		256, 269, 274, 296, 306, 309, 356, 360, 370, 381, 412, 416, 418, 419, 423, 429, 433, 439, 460, 466, 467, 470, 473, 477, 479, 488, 622, 624, 627, 683, 686, 692, 701, 1097, 1101, 1105, 1157, 1164, 1175, 1363, 1366, 1370, 1372, 1378, 1518, 1522, 1525, 1536, 1572, 1576, 1583
	D	
Delegacioni Shtetëror		
Deputetët		36, 65, 75, 79, 80, 87, 88, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 111, 113, 115, 117, 118, 119, 121, 122, 123, 124, 126, 127, 128, 129, 131, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 143, 144, 150, 153, 154, 157, 158, 159, 160, 164, 165, 166, 167, 168, 172, 173, 412, 413, 414, 415, 416, 418, 419, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 426, 427, 429, 433, 439, 440, 449, 450, 451, 452, 453, 454, 455, 457, 458, 460, 461, 462, 463, 464, 465, 466, 467, 957, 958, 959, 960, 961, 964, 966, 969, 974, 1208, 1209,

		1210, 1211, 1212, 1214, 1215, 1216, 1217, 1218, 1219, 1220, 1222, 1221, 1225, 1226, 1227, 1228, 1229, 1230, 1231, 1232, 1233, 1234, 1235, 1236, 1237, 1238, 1239, 1240, 1241, 1242, 1243, 1244, 1643, 1647, 1649, 1651, 1658, 1659, 1663, 1664, 1665, 1679
Dëmet e luftës		
Dorëheqja e Kryeministrit		
	DH	
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DHPGJS)		253, 254, 258, 271, 272, 273, 274, 279, 280, 281, 284, 286, 287, 288, 289, 290, 291, 292, 295, 298, 308, 309, 314, 315, 316, 319, 321, 322, 324, 325, 326, 327, 471, 472, 474, 475, 476, 477, 478, 485, 486, 487, 493, 494, 497, 499, 500, 501, 503, 504, 505, 621, 624, 625, 627, 628, 630, 636, 637, 686, 687, 688, 689, 690, 691, 692, 693, 694, 700, 701, 704, 705, 706, 707, 708, 709, 710, 711, 1093, 1094, 1096, 1097, 1098, 1099, 1100, 1101, 1102, 1103, 1104, 1111, 1112, 1117, 1120, 1121, 1122, 1123, 1126, 1128, 1129, 1131, 1132, 1164, 1165, 1166, 1167, 1168, 1169, 1170, 1172, 1173, 1461, 1462, 1465, 1466, 1471, 1472, 1473, 1477, 1478, 1479, 1480, 1484, 1485, 1486, 1487, 1488, 1489, 1490, 1491, 1688, 1689, 1693, 1694, 1695, 1696, 1697, 1698, 1699, 1700, 1701, 1702, 1703, 1704, 1705, 1706, 1707, 1708, 1709, 1716, 1717, 1718, 1719, 1722, 1723, 1724, 1725, 1726, 1727, 1728, 1729, 1730
	E	
E Drejta		
aktive zgjedhore		

e Lirisë dhe Sigurisë		
e punës dhe ushtrimit të profesionit		1097, 1101, 1105
pasive zgjedhore		
për jetë private		1337
në pronë		392, 587, 1363, 1378
për gjykim të drejtë dhe të paanshëm		13, 14, 19, 32, 46, 82, 176, 177, 180, 181, 192, 197, 209, 210, 219, 229, 250, 252, 256, 258, 264, 269, 274, 292, 294, 297, 298, 300, 306, 309, 327, 329, 330, 332, 333, 337, 338, 344, 353, 355, 356, 360, 370, 381, 383, 407, 470, 473, 477, 479, 488, 505, 510, 513, 519, 539, 540, 543, 553, 559, 560, 562, 574, 575, 583, 589, 598, 620, 622, 624, 625, 627, 632, 639, 641, 643, 653, 654, 656, 657, 662, 673, 680, 681, 683, 686, 687, 692, 695, 701, 712, 713, 715, 723, 726, 733, 747, 749, 752, 754, 762, 771, 776, 794, 795, 797, 799, 804, 806, 813, 819, 821, 823, 824, 825, 827, 828, 830, 852, 853, 854, 856, 857, 860, 863, 871, 872, 882, 883, 885, 886, 888, 889, 892, 894, 920, 922, 924, 925, 928, 929, 930, 938, 939, 950, 951, 952, 980, 983, 986, 991, 998, 1001, 1004, 1013, 1016, 1026, 1027, 1031, 1035, 1042, 1045, 1060, 1062, 1063, 1075, 1097, 1098, 1101, 1105, 1118, 1133, 1136, 1138, 1140, 1164, 1180, 1190, 1193, 1200, 1207, 1247, 1249, 1253, 1254, 1257, 1272, 1278, 1280, 1304, 1306, 1309, 1318, 1321, 1362, 1388, 1392, 1395, 1399, 1409, 1413, 1424, 1428, 1436, 1439, 1444, 1446, 1464, 1493, 1496, 1502, 1503, 1509, 1518, 1522, 1525, 1527, 1532, 1536, 1539, 1540, 1543, 1548, 1554, 1568, 1569, 1570, 1572, 1573, 1576, 1583, 1593, 1596, 1599, 1601, 1614, 1616, 1619, 1642, 1644, 1669, 1685, 1686, 1689, 1710, 1730

për mjete juridike		
për pension		
për proces të rregullt		32, 176, 180, 181, 192, 198, 210, 232, 256, 258, 264, 269, 274, 293, 297, 298, 301, 306, 309, 327, 330, 332, 333, 337, 338, 344, 345, 353, 384, 403, 470, 473, 474, 477, 479, 488, 505, 510, 513, 519, 543, 550, 553, 563, 574, 575, 583, 590, 598, 620, 622, 624, 625, 627, 632, 640, 653, 654, 656, 657, 662, 673, 680, 681, 683, 686, 687, 692, 695, 701, 712, 713, 715, 723, 726, 733, 738, 749, 752, 754, 7662, 771, 776, 795, 797, 799, 804, 806, 813, 814, 819, 921, 823, 825, 827, 828, 830, 852, 854, 857, 860, 863, 871, 872, 882, 883, 886, 888, 889, 892, 894, 920, 924, 925, 928, 929, 930, 938, 939, 950, 951, 952, 998, 1001, 1004, 1016, 1026, 1027, 1031, 1035, 1065, 1097, 1098, 1101, 1105, 1133, 1136, 1138, 1140, 1157, 1174, 1180, 1190, 1191, 1193, 1207, 1247, 1249, 1253, 1255, 1257, 1272, 1278, 1280, 1304, 1309, 1318, 1322, 1362, 1388, 1392, 1395, 1399, 1409, 1439, 1444, 1446, 1447, 1462, 1464, 1496, 1503, 1510, 1532, 1540, 1543, 1549, 1554, 1568, 1570, 1572, 1573, 1576, 1584, 1593, 1596, 1599, 1601, 1614, 1616, 1619, 1642, 1644, 1669, 1686, 1689, 1707, 1711, 1720, 1730
për shitblerje		
për vendim të arsyetuar		
	F	
Forumi i Komisionit të Venecias		

	G	
Grupet parlamentare		953,956, 958, 959, 961, 966, 968, 969, 975, 976, 977
Gjuhët		810, 1733, 1739
Gjykatë e (pa)anshme		550, 560
	GJ	
Gjykata		2, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 23, 25, 26, 27, 29, 30, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 39, dhe vazhdon në gjitha faqet nga 40 – 1730
e Apelit		99, 103, 113, 125, 153, 158, 162, 175, 176, 179, 185, 186, 188, 189, 190, 194, 197, 224, 225, 227, 243, 244, 245, 247, 329, 330, 331, 337, 338, 343, 344, 346, 347, 348, 350, 351, 352, 355, 356, 364, 366, 369, 370, 375, 382, 383, 395, 396, 403, 507, 512, 527, 531, 539, 543, 546, 547, 548, 549, 551, 552, 559, 561, 562, 563, 564, 565, 568, 570, 571, 578, 582, 603, 606, 608, 609, 610, 611, 615, 616, 619, 645, 647, 648, 658, 713, 718, 720, 721, 736, 743, 748, 749, 750, 751, 754, 760, 764, 765, 768, 769, 774, 775, 781, 782, 785, 786, 787, 788, 789, 792, 802, 803, 824, 825, 826, 830, 831, 835, 836, 841, 847, 849, 851, 859, 887, 891, 907, 926, 980, 985, 986, 988, 989, 991, 992, 993, 994, 995, 998, 1004, 1008, 1011, 1014, 1015, 1020, 1022, 1023, 1024, 1025, 1030, 1031,1044, 1050, 1053, 1055, 1056, 1057, 1058, 1060, 1061, 1076, 1081, 1082, 1083, 1086, 1088, 1089, 1090, 1134, 1138, 1139, 1183, 1185, 1186, 1187, 1246, 1247, 1248, 1252, 1263, 1265, 1266, 1270, 1276, 1277, 1293, 1296, 1297, 1300, 1301, 1302, 1308, 1314, 1315, 1316, 1333, 1352, 1358, 1369,

		1372, 1385, 1387, 1391, 1392, 1393, 1394, 1399, 1404, 1411, 1419, 1436, 1442, 1443, 1451, 1454, 1457, 1493, 1495, 1500, 1510, 1518, 1523, 1524, 1533, 1539, 1541, 1545, 1546, 1547, 1553, 1554, 1561, 1652, 1563, 1564, 1565, 1566, 1569, 1575, 1576, 1577, 1578, 1584, 1587, 1590, 1593, 1595, 1596, 1597, 1598, 1605, 1607, 1608, 1610, 1616, 1627, 1628, 1635, 1636, 1637, 1638, 1639, 1641
Themelore		98, 99, 100, 157, 175, 176, 179, 181, 182, 184, 186, 189, 197, 213, 214, 215, 217, 224, 242, 243, 244, 329, 331, 333, 334, 335, 336, 343, 346, 347, 355, 356, 360- 370, 382, 383, 385, 394, 395, 396, 400, 401, 403, 404, 405, 406, 409, 410, 507, 510, 511, 527, 539, 544, 545, 546, 548, 559, 570, 575, 578, 579, 581, 603, 607, 608, 615, 641, 643, 644, 645, 646, 647, 648, 657, 713, 716, 718, 719, 735, 748, 749, 751, 753, 758, 759, 760, 761, 763, 764, 774, 775, 780, 784, 785, 787, 788, 789, 790, 796, 801, 802, 803, 824, 826, 829, 835, 841, 849, 856, 857, 858, 885, 887, 889, 890, 891, 901, 907, 908, 916, 921, 923, 926, 980, 982, 984, 985, 991, 992, 998, 1002, 1003, 1008, 1011, 1013, 1014, 1017, 1021, 1023, 1024, 1031, 1041, 1045, 1046, 1048, 1049, 1050, 1051, 1052, 1053, 1054, 1056, 1057, 1059, 1060, 1077, 1078, 1081, 1082, 1084, 1085, 1086, 1088, 1089, 1090, 1134, 1136, 1137, 1138, 1145, 1168, 1181, 1182, 1183, 1184, 1186, 1187, 1188, 1246, 1248, 1250, 1251, 1252, 1262, 1263, 1269, 1271, 1272, 1273, 1274, 1275, 1276, 1277, 1278, 1292, 1305, 1308, 1310, 1313, 1314, 1315, 1317, 1327, 1333, 1352, 1359, 1363, 1365, 1367, 1368, 1369, 1371, 1377, 1382, 1385, 1387, 1389, 1390, 1399, 1411, 1412, 1414, 1417, 1418, 1419, 1421, 1422, 1423, 1424, 1429, 1432, 1433, 1436, 1442, 1450, 1453, 1467, 1469, 1472, 1474, 1475, 1479, 1487, 1493, 1495, 1496, 1497, 1499,

		1510, 1518, 1519, 1523, 1524, 1525, 1527, 1532, 1535, 1546, 1547, 1553, 1569, 1572, 1573, 1574, 1589, 1595, 1596, 1597, 1598, 1604, 1606, 1608, 1610, 1611, 1612, 1613, 1614, 1615, 1619,1627, 1628, 1634, 1635, 1638, 1639, 1640, 1693, 1715
Supreme		14, 15, 16, 17, 18, 23, 26, 27, 29, 30, 32, 33, 34, 37, 46,55, 63, 64, 65, 66, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 78, 81, 82, 83, 84, 85, 99, 100, 109, 112, 116, 138, 139, 141, 145, 146, 148, 149, 158, 176, 177, 179, 187, 188, 189, 191, 192, 196, 197, 216, 220, 223, 224, 226, 227, 228, 229,233, 243, 246, 248, 249, 332, 355, 356, 364, 368, 382, 385, 394, 395, 403, 412, 413, 414, 415, 418, 422, 423,428, 432, 451, 452, 453, 462, 463, 464, 465, 507, 509, 512, 514, 515, 516, 527, 530, 531, 532, 535,536, 573,583, 585, 586, 587, 588, 604 – 618, 648, 650, 653, 654, 656, 657, 659, 660, 661, 662, 663, 664, 669, 672, 675, 676, 677, 678, 679, 680, 713, 722, 723, 724, 725, 733, 734, 736, 738, 739, 755, 557, 763, 804, 825, 827, 828, 836, 837, 843, 844, 849, 850, 851, 853, 854, 856, 857, 860, 861, 862, 868, 869, 871, 872, 875, 876, 877, 878, 879, 880, 881, 882, 883, 885, 886, 887, 889, 892, 893, 899, 902, 905, 906, 910, 911, 912, 914, 915, 916, 917, 918, 921, 922, 923, 924, 925, 927, 928, 929, 935, 936, 938, 939, 942, 943, 944, 945, 946, 947, 949, 950, 951, 988, 1000, 1004, 1005, 1010, 1011, 1013, 1020, 1031, 1034, 1041, 1044, 1056, 1057, 1058, 1059, 1060, 1078, 1083, 1088, 1089, 1177, 1178, 1179, 1181, 1187, 1188, 1189, 1191, 1192, 1203, 12034, 1269, 1277, 1278, 1279, 1280, 1293, 1296, 1298, 1299, 1303, 1306, 1308, 1316, 1317, 1319, 1333, 1353,1358, 1359, 1360, 1364, 1365, 1370, 1372, 1377, 1380, 1381, 1385, 1386, 1387, 1392, 1393, 1394, 1399, 1403, 1404, 1405, 1406, 1407, 1408, 1411, 1420, 1422, 1423, 1424, 1428, 1432, 1436, 1443,

		1444, 1451, 1452, 1454, 1458, 1493, 1494, 1495, 1500, 1501, 1502, 1503, 1510, 1511, 1513, 1514, 1516, 1518, 1519, 1524, 1525, 1526, 1527, 1533, 1534, 1535, 1541, 1546, 1547, 1548, 1554, 1561, 1562, 1563, 1564, 1569, 1576, 1577, 1578, 1584, 1588, 1589, 1590, 1591, 1592, 1597, 1598, 1612, 1613, 1614, 1616, 1618, 1628, 1638, 1640
	I	
Imunitet funksional		1733
Institucionet e Pavarura		1667, 1668, 1733, 1741
	J	
Jurisdiksioni i Gjykatës Kushtetuese		1733
	K	
Kërkesë e bashkuar		1734
Kërkesë e paafatshme		1134
Kërkesë e papranueshme		114, 507, 980, 998, 1041, 1246
Kërkesë e pranueshme		87, 175, 355, 539, 570, 621, 653, 747, 921, 1569
Kërkesë individuale		13, 175, 208, 252, 294, 329, 355, 400, 412, 469, 507, 539, 570, 621, 641, 653, 682, 747, 794, 824, 853, 885, 1013, 1041, 1093, 1134, 1177, 1246, 1305, 1363, 1385, 1410, 1436, 1461, 1539, 1569, 1595, 1685
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë		99, 100, 187, 722, 748, 768, 775, 1086, 1420, 1596, 1628
Kërkesë qartazi e pabazuar		507, 1041, 1363

Këshilli i Evropës		446
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK)		794, 795, 797, 798, 800, 801, 802, 803, 804, 805, 813, 815, 816, 817, 818, 819, 820, 821, 822, 1013, 1014, 1018, 1019, 1020, 1021, 1023, 1024, 1026, 1029, 1030, 1031, 1032, 1033, 1034, 1035, 1036, 1037, 1038, 1039, 1182, 1183, 1184, 1185, 1186, 1187, 1188, 1645, 1651, 1652, 1653, 1655, 1656, 1657, 1658, 1659, 1666, 1667, 1668, 1669, 1670, 1671, 1672, 1673, 1674, 1675, 1676, 1677, 1678, 1680, 1681
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)		102, 120, 139, 145, 420, 961, 966, 974, 975, 1214
Kompetencat		1233
e Qeverisë		1233
e Kuvendit		1672, 1740
e Presidentit		974, 975
Konfesionet fetare		1734
Kontest zgjedhor		15, 83
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut		1734
Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje		1734, 1735
Kryeministri i Republikës së Kosovës		1735
Kryetar Komune		135, 1735

Kryqi i Kuq		1735
Kufizim i të drejtave		13, 38, 39, 65, 134, 147, 403, 412, 418, 423, 429, 433, 434, 439, 1322, 1347, 1348
Kuvendi i Republikës së Kosovës		17, 85, 91, 154, 171, 818, 840, 906
	L	
Ligji		
për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës		805, 808, 815, 818, 1028, 1033, 1035, 1643, 1644, 1645, 1651, 1661, 1667, 1672, 1674
për Noterinë		
	M	
Masa e Përkohshme		13, 19, 35, 36, 37, 378, 325, 436, 447, 577, 579, 583, 585, 588, 594, 600, 606, 607, 608, 610, 615, 616, 682, 687, 691, 700,725, 745, 955, 957, 964, 976, 979, 1117, 1331, 1151, 1152, 1164, 1165, 1221, 1222, 1225, 1242, 1250, 1259, 1599, 1602, 1617, 1619, 1641, 1643, 1648, 1650, 1682, 1707
Mbrojtja e pronës		
Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave		
Mendim mospajtues		
Ministria (ministri)		
Mjet juridik efektiv		
	N	

Ndalimi i diskriminimit		356, 360, 371, 382, 412, 416, 418, 419, 423, 439, 442, 460, 466, 467, 1097, 1101, 1106
Ndarja e pushtetit		
	P	
Paanshmëria e gjykatës		540, 560, 561, 562, 564, 565, 568, 1042, 1061, 1085, 1086, 1091
Palët/Pala e Autorizuar/a		13, 19, 33, 37, 40, 41, 44, 53, 87, 94, 126, 149, 180, 126, 206, 270, 297, 307, 332, 341, 360, 379, 406, 438, 484, 415, 418, 438, 473, 474, 525, 557, 596, 624, 628, 643, 648, 656, 670, 686, 693, 730, 752, 765, 811, 827, 833, 856, 869, 888, 899, 924, 936, 954, 955, 957, 962, 965, 967, 971, 972, 973, 989, 1001, 1006, 1028, 1029, 1045, 1073, 1097, 1110, 1136, 1142, 1180, 1198, 11211, 1228, 1249, 1256, 1272, 1290, 1309, 1330, 1360, 1374, 1388, 1397, 1413, 1425, 1439, 1448, 1464, 1481, 1496, 1507, 1522, 1530, 1542, 1551, 1572, 1581, 1599, 1624, 1625, 1643, 1648, 1663, 1689, 1714
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)		14, 16, 17, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 30, 31, 37, 42, 44, 71, 72, 73, 76, 77, 78, 80, 81, 82, 84, 85, 86, 90, 110, 119, 145, 149, 171, 244, 412, 414, 415, 416, 420, 421, 422, 423, 428, 439, 440, 449, 450, 451, 452, 453, 455, 460, 461, 462, 463, 464, 465, 467, 521, 589, 1220
Paraburgim(i)		1052, 1053, 1054, 1067, 1068, 1069, 1539, 1543, 1544, 1736
Parashkrim		896, 1070, 1138, 1139, 1141, 1142, 1344, 1363, 1367, 1368, 1369, 1370, 1373, 1374, 1377, 1378, 1379, 1380, 1381, 1382, 1442, 1493, 1494, 1502, 1505, 1506, 1507, 1511, 1513, 1514, 1516, 1569, 1579, 1580, 1592, 1694, 1696

Parimet e Përgjithshme		13, 15, 19, 41, 52, 56, 63, 83, 211, 218, 222, 234, 239, 252, 274, 291, 294, 309, 310, 326, 332, 341, 344, 348, 391, 440, 449, 453, 470, 488, 503, 510, 520, 525, 535, 542, 557, 574, 591, 597, 599, 604, 611, 633, 656, 670, 673, 683, 701, 729, 740, 749, 752, 760, 767, 776, 782, 791, 794, 825, 827, 833, 836, 837, 845, 853, 856, 869, 873, 874, 886, 888, 900, 903, 912, 924, 936, 940, 941, 965, 1001, 1006, 1042, 1045, 1060, 1062, 1064, 1075, 1093, 1112, 1131, 1177, 1180, 1198, 1201, 1233, 1255, 1258, 1263, 1266, 1272, 1290, 1305, 1306, 1307, 1335, 1361, 1386, 1397, 1400, 1447, 1483, 1556, 1569, 1581, 1584, 1599, 1625, 1639, 1668, 1680, 1711, 1719, 1720, 1722
Parimi		
i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në raste penale		194, 232, 233, 234, 235, 236, 237, 247, 250, 713, 714, 723, 726, 733, 739
i Proporcionalitetit		587, 957, 961, 969
i Sigurisë Juridike		92, 173, 749, 762, 776, 777, 778, 786, 788, 789, 791, 852, 919, 1157, 1174, 1190, 1200
i subsidiaritetit		37, 815, 822, 1456, 1486, 1511
Pension/pensionimi		261, 365, 794, 799, 801, 805, 811, 813, 816, 1569, 1573, 1575, 1580, 1587, 1588, 1589, 1590, 1592
Person(a) Juridik(ë)		184, 200, 224, 225, 245, 334, 379, 570, 921, 998, 1004, 1005, 1009, 1010, 1011, 1269
Përbërja e trupit gjykues		1528
Përmbarimi		355, 356, 357, 364, 365, 366, 367, 368, 370, 371, 375, 376, 377, 378, 379, 381,

		382, 383, 386, 387, 388, 389, 390, 391, 394, 355, 397, 398, 539, 544, 545, 547, 548, 549, 550, 559, 560, 641, 644, 645, 646, 650, 748, 756, 757, 773, 774, 796, 818, 820, 1013, 1014, 1018, 1020, 1032, 1033, 1035, 1036, 1038, 1039, 1462, 1469, 1781, 1596, 1606, 1609
Presidenti i Republikës së Kosovës		21, 65, 92, 101, 107, 119, 167, 172, 173, 420, 954, 966, 967, 968, 970, 971, 972, 974, 978, 1226
Pritje(t) legjitime		272, 396, 518, 537, 805, 1591
Privatizimi		252, 258, 259, 260, 273, 294, 298, 299, 308, 469, 474, 475, 476, 487, 627, 682, 688, 690, 700, 1099, 1117
Procedura		
Administrative		
Civile		
Penale		750, 757, 774, 780, 787, 788, 789, 792, 1051, 1067, 1083, 1184, 1410, 1416, 1418, 1420, 1423, 1445, 1498
Prokurori i Shtetit		719, 748, 758, 774, 1042, 1045, 1053, 1059, 1060, 1061, 1062, 1064, 1066, 1067, 1068, 1065, 1070, 1071, 1072, 1073, 1075, 1084, 1145, 1062, 1168, 1370, 1529, 1613
Prokurori Publik		1142, 1624, 1640
	Q	
Qasja në gjykatë		405, 1578, 1586

Qeveria e Republikës së Kosovës		17, 37, 1233, 1392
	R	
Ratione materiae		598, 1246, 1247, 1253, 1257, 1258, 1261, 1410, 1411, 1427, 1431, 1434
Res judicata		396, 648, 747, 748, 749, 750, 762, 763, 764, 768, 769, 770, 773, 775, 776, 777, 778, 779, 780, 782, 783, 784, 785, 786, 787, 788, 789, 790, 791, 792, 1165, 1166, 1173
Rigjykim		99, 100, 153, 224, 249, 269, 270, 293, 306, 327, 363, 478, 539, 540, 547, 548, 552, 559, 569, 693, 712, 718, 720, 722, 802, 860, 1013, 1020, 1021, 1022, 1031, 1053, 1057, 1058, 1060, 1061, 1082, 1085, 1088, 1090, 1090, 1184, 1186, 1187, 1188, 1417, 1423, 1425, 1429, 1430
	S	
Seancë dëgjimore		97, 98, 110, 145, 146, 148, 154, 159, 161, 164, 175, 176, 198, 229, 230, 252, 253, 267, 268, 273, 274, 275, 276, 277, 278, 279, 280, 281, 282, 283, 284, 285, 286, 288, 289, 290, 291, 292, 294, 295, 299, 303, 305,308, 309, 310, 311, 312, 313, 314, 315, 316, 317, 318, 319, 320, 321, 323, 324, 325, 326, 327, 469, 470, 471, 478, 487, 488, 489, 490, 491, 492, 493, 494,495, 496, 497, 498, 499, 501, 502, 503, 504, 682, 683, 684, 687, 689, 692, 697, 699, 700, 701, 702, 703, 704, 705, 706, 708, 709, 710, 711, 713, 715, 744, 745, 823, 1093, 1094, 1095, 1102, 1107, 1109, 1112, 1114, 1115, 1116, 1117, 1118, 1119, 1120, 1121, 1122, 1123, 1124, 1125, 1126, 1127, 1128, 1129, 1130, 1131, 1132, 1133,

		1214, 1222, 1225, 1241, 1242, 1245, 1246, 1251, 1252, 1262, 1265, 1608, 1611, 1612, 1613, 1616, 1619, 1621, 1627, 1628, 1629, 1643, 1658, 1682, 1683, 1693, 1695
Sundimi i Ligjit		13, 35, 56, 57, 58, 67, 68, 89, 112, 169, 170, 239, 371, 386, 432, 442, 586, 635, 660, 679, 740, 749, 762, 777, 778, 791, 795, 821, 837, 903, 1037, 1157, 1158, 1168, 1174, 1175, 1349, 1540, 1557, 1562, 1565, 1567, 1584
	SH	
Shërbimi Civil		794, 796, 797, 800, 801, 802, 803, 804, 805, 807, 808, 809, 815, 817, 823, 1018, 1027, 1028, 1032, 1033, 1177, 1182, 1185, 1224, 1539, 1544, 1560, 1563, 1565, 1643, 1644, 1645, 1646, 1647, 1648, 1650, 1651, 1652, 1653, 1654, 1655, 1658, 1660, 1661, 1665, 1666, 1667, 1668, 1669, 1670, 1671, 1673, 1675, 1676, 1677, 1679, 1680, 1681, 1682, 1683, 1684
	T	
Taksë gjyqësore		365, 369, 396, 400, 405, 409, 476
Të drejtat		
e fëmijëve		1306, 1309, 1313, 1314, 1315, 1318, 1320, 1321, 1323, 1331, 1332, 1345, 1352, 1360
e personave transgjinor		
zgjedhore dhe të pjesëmarrjes		13, 14, 19, 21, 24, 32, 38, 46, 82, 104, 116, 143, 412, 416, 418, 419, 423, 428, 432, 433, 439, 460, 466, 467, 1151
	V	
Veprim retroaktiv i ligjit		235, 663

Vlerat demokratike		
	Z	
Zgjedhjet lokale/ komunale		135, 957, 964, 976

INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS

Neni	Titulli/Emërtimi		Numri i faqes
	KAPITULLI I DISPOZITAT THEMELORE		
5	Gjuhët		
7	Vlerat		14, 19, 32, 46, 82, 412, 418, 423, 429, 432, 439, 1157, 1175, 1518, 1522, 1525, 1536
	KAPITULLI II TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE		
21	Parimet e përgjithshme		13, 19, 41, 51, 52, 332, 341, 510, 525, 542, 557, 574, 597, 656, 670, 752, 766, 827, 833, 856, 869, 888, 900, 924, 936, 1001, 1006, 1180, 1198, 1272, 1290, 1388, 1397, 1581, 1599, 1625
2	Zbatimi i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare		
24	Barazia para ligjit		256, 269, 274, 296, 306, 309, 381, 412, 416, 418, 419, 423, 429, 433, 439, 460, 466, 467, 470, 473, 477, 479, 488, 622, 624, 627, 683, 686, 692, 701, 1097, 1101, 1164, 1366, 1370, 1372, 1378, 1572, 1576, 1583
2	Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshterues		

29	E drejta e lirisë dhe sigurisë		
30	Të drejtat e te akuzurit		
31	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm		13, 14, 19, 32, 46, 82, 176, 180, 192, 197, 209, 210, 256, 258, 269, 274, 292, 297, 298, 306, 309, 327, 329, 330, 332, 333, 337, 344, 353, 356, 360, 370, 381, 383, 470, 473, 477, 488, 505, 510, 513, 519, 540, 543, 553, 559, 560, 574, 575, 583, 598, 620, 622, 624, 625, 627, 632, 639, 641, 643, 653, 654, 656, 657, 662, 673, 680, 681, 683, 686, 687, 692, 701, 712, 713, 715, 723, 733, 749, 752, 754, 762, 776, 795, 797, 799, 804, 813, 821, 823, 825, 827, 828, 830, 852, 854, 856, 857, 860, 863, 871, 882, 883, 886, 888, 889, 892, 920, 922, 924, 925, 928, 929, 938, 950, 951, 952, 980, 983, 986, 991, 998, 1001, 1004, 1016, 1026, 1031, 1035, 1042, 1045, 1060, 1062, 1075, 1097, 1098, 1101, 1118, 1133, 1136, 1138, 1164, 1180, 1190, 1193, 1207, 1247, 1253, 1257, 1272, 1278, 1304, 1309, 1318, 1362, 1388, 1392, 1395, 1399, 1409, 1413, 1428, 1439, 1444, 1464, 1496, 1502, 1503, 1509, 1518, 1522, 1525, 1527, 1532, 1540, 1543, 1554, 1568, 1570, 1572, 1573, 1576, 1583, 1593, 1596, 1599, 1601, 1614, 1616, 1642, 1644, 1669, 1686, 1689, 1730
32	E drejta për mjete juridike		72, 355, 356, 360, 370, 371, 381, 387, 388, 390, 403, 571, 574, 583, 584, 590, 598, 604, 618, 622, 624, 627, 980, 983, 986,

			991, 993, 995, 1045, 1060, 1164, 1413, 1425, 1428, 1542, 1548, 1549, 1572, 1576
33	Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në raste penale		
45	Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes		13, 14, 19, 21, 32, 38, 46, 82, 105, 116, 143, 412, 416, 418, 419, 423, 428, 432, 433, 439, 460, 466, 467, 1151
4	Mbrojtja e pronës		256, 269, 274, 297, 306, 309, 356, 360, 371, 381, 391, 393, 403, 470, 473, 477, 488, 510, 513, 519, 571, 574, 584, 598, 604, 618, 619, 683, 686, 692, 701, 797, 804, 1164, 1366, 1370, 1378, 1518, 1522, 1686, 1689, 1706, 1707, 1710
4	E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit		
5	Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut		
54	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave		387, 388, 390, 403, 571, 574, 584, 598, 604, 618, 622, 624, 627, 1045, 1060, 1075, 1164, 1366, 1370, 1378, 1496, 1502, 1503, 1509, 1510, 1516, 1518, 1522, 1525, 1536, 1539, 1542, 1548, 1566, 1572, 1576, 1583
KAPITULLI IV KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS			
65	Kompetencat e Kuvendit		1644, 1651, 1672

66	Zgjedhja dhe Mandati		
67	Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve		
KAPITULLI V PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS			
83	Statusi i Presidentit		
84	Kompetencat e Presidentit		974, 975
KAPITULLI VI QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS			
92	Parimet e Përgjithshme		
93	Kompetencat e Qeverisë		1233, 1740, 1742
94	Kompetencat e Kryeministrit		1740, 1742
101	Shërbimi Civil		817, 1032, 1643, 1646, 1648, 1650, 1654, 1660, 1665, 1670, 1671, 1682, 1683
KAPITULLI VII SISTEMI I DREJTËSISË			
1	Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor		1042, 1045, 1060, 1062, 1064, 1075, 1741
KAPITULLI VIII GJYKATA KUSHTETUESE			
112	Parimet e Përgjithshme		51, 52, 54

113	Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara		13, 19, 40 , 87, 94, 126, 180, 206, 256, 270, 297, 307, 332, 341, 360, 379, 412, 438, 473, 484, 510, 525, 557, 574, 596, 624, 628, 643, 648, 656, 686, 653, 730, 752, 765, 827, 833, 856, 888, 899, 924, 938, 967, 983, 989, 1001, 1006, 1028, 1045, 1073, 1110, 1136, 1142, 1180, 1198, 1211, 1249, 1256, 1272, 1290, 1330, 1360, 1366, 1377, 1388, 1397, 1413, 1448, 1464, 1481, 1496, 1507, 1522, 1530, 1542, 1551, 1571, 1572, 1624, 1648, 1663, 1689, 1714
115	Organizimi i Gjykatës Kushtetuese		
Kapitulli IX MARËDHËNIET EKONOMIKE			
119	Parimet e Përgjithshme		
Kapitulli XII INSTITUCIONET E PAVARURA			
132	Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit		429
133	Zyra e Avokatit të Popullit		
136	Auditori i Përgjithshëm i Kosovës		
140	Banka Qendrore e Kosovës		

141	Komisioni i Pavarur Medieve		1667
142	Agjencitë Pavarura		
SHKELJE TË NENEVE 4, 7, 24, 29, 31, 46, 65, 93, 94 dhe 119 DHE TË KUSHTETUTËS			
4	Forma e qeverisjes dhe ndarja e pushtetit		
7	Vlerat		13, 14, 19, 46, 82, 423, 427, 429, 440, 441, 459, 1157, 1175, 1518, 1522, 1525, 1536, 1538
24	Barazia para Ligjit		356, 358, 360, 370, 381, 398, 419, 424, 429, 432, 433, 439, 441, 456, 467, 473, 477, 478, 628, 639, 693, 980, 992, 1093, 1094, 1097, 1101, 1103, 1104, 1105, 1112, 1130, 1132, 1364, 1370, 1572, 1576, 1579, 1583
29	E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë		
31			32, 72, 176, 177, 180, 187, 196, 197, 209, 210, 213, 219, 220, 221, 223, 228, 229, 233, 250, 252, 264, 272, 275, 277, 290, 291, 292, 295, 298, 300, 306, 310, 311, 325, 327, 329, 330, 332, 333, 337, 338, 344, 350, 352, 353, 356, 360, 370, 381, 383, 386, 387, 388, 400, 407, 409, 410, 470, 473, 477, 478, 479, 487, 488, 490, 503, 504, 505, 506, 507, 510, 518, 519, 528, 533, 535, 540, 542, 543, 550, 553, 559, 560, 562, 568, 570, 571, 574, 575, 583, 584, 589, 598, 599, 602, 604, 606, 612, 614, 620, 622, 632, 633, 634, 635, 639, 641, 643, 653, 656, 661, 664, 672,

	E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm		673, 679, 681, 682, 687, 695, 710, 711, 714, 723, 725, 726, 737, 744, 750, 752, 754, 762, 764, 771, 786, 788, 789, 790, 792, 794, 797, 804, 806, 813, 820, 822, 827, 832, 839, 845, 851, 852, 860, 871, 875, 881, 883, 888, 894, 905, 912, 913, 914, 920, 924, 928, 930, 938, 942, 949, 952, 957, 972, 980, 983, 985, 991, 1001, 1014, 1016, 1026, 1027, 1031, 1032, 1036, 1038, 1062, 1063, 1066, 1075, 1076, 1078, 1094, 1097, 1098, 1101, 1105, 1113, 1115, 1117, 1118, 1119, 1130, 1132, 1140, 1180, 1193, 1200, 1205, 1206, 1247, 1249, 1253, 1254, 1257, 1258, 1261, 1263, 1264, 1267, 1272, 1273, 1278, 1280, 1294, 1303, 1304, 1307, 1309, 1311, 1314, 1318, 1321, 1331, 1332, 1335, 1355, 1356, 1360, 1361, 1382, 1393,1394, 1395, 1400, 1401, 1411, 1413, 1424, 1425, 1428, 1431, 1436, 1437, 1439, 1444, 1446, 1451, 1453, 1456, 1459, 1460, 1462, 1464, 1481, 1493, 1503, 1510, 1515, 1519, 1522, 1525, 1527, 1528, 1532, 1534, 1536, 1543, 1548, 1554, 1555, 1556, 1557, 1559, 1562, 1567, 1572, 1576, 1578, 1583, 1585, 1586, 1592, 1593, 1596, 1597, 1616, 1619, 1629, 1639, 1640, 1670, 1686, 1687, 1689, 1706, 1707, 1707, 1709, 1710, 1719, 1727, 1728, 1729
46	Mbrojtja e Pronës		356, 357, 383, 360, 361, 371, 373, 381, 391, 392, 393, 397, 398, 399, 473, 477, 508, 510, 513, 517, 518, 519, 528, 536, 537, 572, 574, 581, 584, 618, 619, 797, 804,

			807, 1104, 1364, 1371, 1378, 1381, 1382, 1383, 1518, 1522, 1525, 1536, 1686, 1689, 1706, 1707, 1710, 1719
65	Kompetencat e Kuvendit		1644, 1646, 1651, 1672, 1673, 1674, 1675, 1676, 1681
93	Kompetencat e Qeverisë		1233
94	Kompetencat e Kryeministrit		
11	Parimet e Përgjithshme		